

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

FJALORI
ENCIKLOPEDIK
I KOSOVËS

II
L-ZH



AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
FJALORI ENCIKLOPEDIK I KOSOVËS

KOSOVA ACADEMY OF SCIENCES AND ARTS

ENCYCLOPEDIA DICTIONARY OF KOSOVA

II
L-ZH



PRISHTINA, 2018

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

FJALORI ENCIKLOPEDIK I KOSOVËS

II
L-ZH



PRISHTINË, 2018

KRYEREDAKTOR DHE REDAKTOR PËRGJEGJËS:
Akademik Mehmet Kraja

REDAKSIA QENDRORE:

Akademik Pajazit Nushi, akademik Ali Aliu, akademik Tahir Emra,
(akademik Zeqirja Ballata), akademik Rexhep Ismajli, akademik Eqrem Basha,
akademik Fejzullah Krasniqi, akademik Mehmet Kraja

ISBN 978-9951-615-84-6

ISBN 978-9951-615-86-0

Copyright © Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës (ASHAK)

Rr. Agim Ramadani nr. 305, 10000 Prishtinë

Republika e Kosovës

Tel. +383 38 249 303; fax. +383 38 244 636

E-mail: ashak@ashak.org

KËSHILLI BASHKËRENDUES:

Akademik Idriz Ajeti, akademik Mark Krasniqi, akademik Minir Dushi,
akademik Besim Bokshi, akademik Feriz Krasniqi, akademik Nexhat Daci,
akademik Engjëll Berisha

BORDI:

Akademik Hivzi Islami, akademik Isuf Krasniqi, akademik Rexhep Ismajli,
akademik Esat Stavileci, akademik Latif Susuri, akademik Rexhep Ferri

REDAKSIA QENDRORE:

Akademik Pajazit Nushi, akademik Ali Aliu, akademik Tahir Emra (akademik Zeqirja Ballata), akademik Rexhep Ismajli, akademik Eqrem Basha, akademik Fejzullah Krasniqi, akademik Mehmet Kraja (kryeredaktor), sekretare e redaksisë: Lendita Juniku Pula

REDAKSITË E FUSHAVE:

REDAKSIA E GJEOGRAFISË FIZIKE:

Dr. Ruzhdi Pllana (redaktor), dr. Vahdet Pruthi, dr. Valbon Bytyçi;

REDAKSIA E GJEOGRAFISË SOCIALE:

Dr. Ibrahim Ramadani (redaktor), dr. Gani Gashi, dr. Arsim Ejupi;

REDAKSIA E ARKEOLOGJISË DHE KOHËS SË LASHTË:

Dr. Edi Shukriu (redaktore), dr. Exhlale Dobruna-Saliu, dr. Arben Hajdari;

REDAKSIA E HISTORISË SË MESJETËS DHE PERIUdhËS BIZANTINE:

Dr. Jahja Drançolli (redaktor), dr. Muhamet Mala, dr. Qerim Dalipi;

REDAKSIA E PERIUdhËS OSMANE DHE KULTURËS ORIENTALE:

Dr. Gazmend Rizaj (redaktor), dr. Nehat Krasniqi, dr. Sadik Mehmeti;

REDAKSIA E HISTORISË SË SHEK. XIX:

Akademik Jusuf Bajraktari (redaktor), dr. Frashër Demaj, dr. Isa Bicaj;

REDAKSIA E HISTORISË SË SHEK. XX:

Dr. Fehmi Rexhepi (redaktor), dr. Sulltane Ukaj, dr. Izber Hoti;

REDAKSIA E LUFTËS SË VITEVE 1998-1999:

Sylë Ukshini (redaktor), dr. Sabit Ukaj, mr. Ruzhdi Jashari;

REDAKSIA E FUSHËS POLITIKE-JURIDIKE:

Dr. Blerim Reka (redaktor), dr. Osman Ismajli, mr. Ilir Dugolli;

REDAKSIA E EKONOMISË:

Dr. Muhamet Mustafa (redaktor), dr. Selman Selmanaj, dr. Petrit Gashi;

REDAKSIA E ARSIMIT:

Dr. Harullah Koliqi (redaktor), dr. Afërdita Deva-Zuna, dr. Islam Krasniqi;

REDAKSIA E MJEKËSISË:

Dr. Isuf Dedushaj (redaktor), dr. Avdyl Krasniqi, dr. Ismajl Dreshaj;

REDAKSIA E ALBANOLOGJISË:

Dr. Bardh Rugova (redaktor), dr. Lindita Tahiri, mr. Shpëtim Elezi;

REDAKSIA E SHKENCAVE TË NATYRËS:

Akademik Latif Susuri (redaktor), dr. Ramadan (Agim) Zajmi, dr. Behxhet Mustafa;

REDAKSIA E SHKENCAVE SOCIALE:

Akademik Anton Berisha (redaktor), dr. Nita Luci, mr. Kristë Shtufi;

REDAKSIA E SHKENCAVE TEKNIKE:

Akademik Minir Dushi (redaktor), akademik Isuf Krasniqi, akademik Fejzullah Krasniqi;

REDAKSIA E LETËRSISË:

Akademik Sabri Hamiti (redaktor), akademik Ali Aliu, akademik Eqrem Basha;

REDAKSIA E ARTIT MUZIKOR:

Akademik Zeqirja Ballata (redaktor), akademik Engjëll Berisha, mr. Arnisa Rexhepi;

REDAKSIA E ARTEVE PAMORE:

Akademik Tahir Emra (redaktor), akademik Rexhep Ferri, dr. Hivzi Muharremi;

REDAKSIA E ARTEVE SKENIKE DHE FILMIT:

Fadil Hysaj (redaktor), dr. Besim Rexhaj, Bekim Lumi;

REDAKSIA E TRASHËGIMISË KULTURORE:

Dr. Fejaz Drançolli (redaktor), dr. Shpresa Siqeca, dr. Sadri Fetiu.

REDAKSIA E INFORMIMIT:

Dr. Ibrahim Berisha (redaktor), dr. Milazim Krasniqi, dr. Rrahman Paçarizi;

REDAKSIA E RELIGJIONIT:

Dr. Qemal Morina (redaktor), mr. Kristë Shtufi, Nexhat Ibrahim;

REDAKSIA E SPORTIT:

Xhavit Kajtazi (redaktor), Gani Kosumi, Baki Berisha;

L

LA PIANA Marko (Marco) (1883-1958).

Filolog, albanolog arbëresh. Lindi në Horën e Arbëreshëve në Sicili. Ka studiuar në Universitetin e Palermos dhe si i ri është përqendruar në studimet indeoeuropiane me theks të veçantë gjuhën shqipe. Ka kryer studim krahasimtar për sistemin e zanoreve në shqipen dhe në latinishten (1937) dhe ka publikuar prelegomenë për gjuhësinë shqiptare (1939), një studim për dialektet arbëreshe (1949), një tjetër për bashkëtingëlloret likuide dhe ato hundore të shqipes (1952) si dhe një për prefiksin la- në gjuhën shqipe (1957). Më 1912 ka publikuar në Romë një kopje të veprës së Lekë Matrëngës. Jo të gjitha veprat e La Pianës kanë pasur fatin të botoheshin. Një fjalor etimologjik të shqipes dhe një gramatikë historike të shqipes, të cilat kujtoheshin të zhdukura pas vdekjes së autorit janë raportuar se gjenden në bibliotekën e seminarit arbëresh në Horën e Arbëreshëve. La Piana ka pasur karrierë të shkurtër akademike si profesor i jashtëm i gjuhës shqipe në Universitetin e Palermos. Në vitin shkollor 1951/52 ka mbajtur një kurs për elementet indo-europiane në morfologjinë e shqipes. (Sejdi Gashi)

LABAN Aleksandar (1927-1975). Agronom, pylltar. Lindi në Skivjan, afër Gjakovës. Kreu gimnazin në Beograd, Fakultetin e Bujqësisë dhe të Pylltarisë i mbaroi po në Beograd. Studimet pasuniversitare në lëmin e fitopatologjisë dhe ekologjisë dhe tezën e disertacionit në lëmin e mbrojtjes së bimëve i mbrojti po në Fakultetin e Bujqësisë të Universitetit të Beogradit (1974). Ishte ekspert i dalluar i bujqësisë dhe i pylltarisë dhe shumë i angazhuar në hapjen e sipërfaqeve të reja të tokës bujqësore dhe ngritjen e pemishteve të reja në rajonin e Dukagjinit. Ishte organizator

i shërbimeve profesionale bujqësore në Kosovë dhe drejtor i stacionit bujqësor në Gjakovë (1963-1969), më pas drejtor i Institutit Bioteknik në Pejë (1969-1975). Publikoi shumë punime shkencore dhe profesionale nga fusha e pemëtarisë dhe e mbrojtjes së bimëve. (Latif Susuri)

LABIRINTI I SMIRËS. Është përfytyrim dardan i ciklit të jetës dhe i rendit kozmik. Ka trajtë rrethi dhe gjendet në monumentin votiv përkushtuar Hyjneshës Dardane nga



MONUMENTI GUROR I LABIRINTIT TË SMIRËS

Smira e Vitisë (211). Është relievu në bllok të mermerit vendor në trajtë katërkëndëshi (78 x 36 x 37cm) dhe i ka katër faqe të trajtuara, gjë që në territorin e Dardanisë nuk është aq e shpeshtë. Në të dy faqet e kundërta të monumentit gjenden labirinti rrethor dhe ai katërkëndësh dhe në të tjerat dy tekste

identike të skalitura. Fushat e simboleve dhe të mbishkrimeve janë vendosur në korniza të theksuara (34.5 x 22.5 cm). Kapiteli dhe bazamenti i monumentit janë dëmtuar gati tërësisht, në pjesën e poshtme të tij duken gjurmët e gjetheve të lerthit dhe nën to brezi me vija relieveve. Dedikuesi i monumentit është Artorius Heraclitus, speculator (vëzhgues) i Legjionit IV të Flavëve.

Labirinti rrethor i Smirës është i qarkut të mbyllur, pa hyrje të dukshme, që e bën të jetë unik për rajonin e më gjerë. Ndahet në hapësira madhësish të ndryshme përmes shtigjeve të trajtësuara nga gjashtë svastika (kryqe të thyer). Tri svastika kanë drejtime kah lindja dhe simbolizojnë lindjen dhe tri të tjera drejtohen kah perëndimi dhe simbolizojnë vdekjen-ringjalljen. Qendrën e zë gjysmësfera e theksuar, e cila është ndarë në tri hapësira përmes tri gjysmëharqeve. Ky labirint është pjesë qendrore e kompozicionit të përbërë edhe nga hardhia e rrushit mbi labirint, degët e lerthit dhe nyjën profilaktike nën të. Nyja e mbron hyrjen në labirintin e jetës. Gjithë kompozicionin e dominon koncepti i treshit, i cili paraqet formulën dardane të krijimit të tri botëve të paramenduara, të asaj tokësore, të nëndheshme dhe qiellore. Ndërlidhja midis diellit apo cakut të mbretërisë së vetëdijes më të lartë dhe të botës materiale paraqitet përmes hardhisë së rrushit dhe degëve të lerthit.

Labirinti shpreh kompleksitet teogonik, filozofik dhe kozmologjik dardan, që sjell frymë të identitetit dardan përmes skemës unike ikonografike. Rregulli i paramenduar kozmik shquhet përmes një qasje gjeometrike-numerologjike, që krijon fushë holografike shumë-dimensionale (gjeometri e shenjtë). Është tregues i njohurive kozmologjike dardane dhe i pranisë së qiellvrotuesve dardanë, të cilët i vrojtonin lëvizjet e trupave qiellorë dhe të yjeve, i shënonin këto dhe krijonin përfytyrimin për kozmosin. Nga kjo dëshkohet dhe prezenca e udhëheqësve shpirtërorë dhe të “shkencëtarëve” të kohës. Labirintet e monumentit të Smirës përcjellin mesazh të njëjtë të ciklit të jetës dhe të përjetësisë, ai rrethor me qark të mbyllur përmes traditës dardane dhe ai katërkëndësh, me hyrje të dukshme, përmes traditës helene. Veçoritë dhe arkitektura unike e labirintit rrethor të Smirës bën që të njihet me emrin Labirinti Dardan. (Edi Shukriu)

LABORATORI QENDROR PËR DIAGNOSTIFIKIMIN E MATERIALEVE. U themelua në vitin 2003 me njësinë e vetme për diagnostifikimin e materialeve. Laboratori përbëhet nga sektori për provat dhe kontrollin e materialit me shkatërrim dhe pa shkatërrim, i korrozionit, i metalografisë dhe sektori i trajtimit termik të materialit. Këta sektorë shërbejnë kryesisht për kryerjen e ushtrimeve laboratorike të studentëve dhe ofrojnë shërbime eksperimentale dhe për punë në ekonomi. Në këtë laborator i mbajtën ushtrimet studentët e Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike të Prishtinës, të Fakultetit të Xehetarisë dhe të Metalurgjisë të Mitrovicës, të Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore të Prishtinës, të Fakultetit të Shkencave të Aplikuara Teknike të Ferizajt, të disa degëve të Fakultetit të Edukimit të Prishtinës dhe të Fakultetit të Shkencave Teknike të Aplikuara të Mitrovicës. Laboratori kishte kontakte bashkëpunimi me laboratorin e Universitetit Teknik të Frajbergut të Gjermanisë dhe falë donacioneve nga DAAD-i (fondacion gjerman për shkëmbime akademike) u mbajtën disa simpoziume bashkëpunimi nga kjo fushë. Me vendimin e rektoratit të vitit 2011, Laboratori Qendror kaloi në përbërje të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike të Universitetit të Prishtinës. (Fehmi Krasniqi)

LABUTZA. Qytet me rang municipal i periudhës antike. Prokopi i Cezaresë e vendos në listën e tij si fortesë dardane e rindërtuar nga Justiniani në shek. VI. Është dëshmuar nga monumentet epigrafike të zbuluara në Smirë, me shkurtesën e emrit të qytetit dhe nocionet dekurion dhe municipium. Qyteti u ubifikua nga E. Shukriu te fshati Gashaj (Gushicë) i Vitisë, në lokalitetin me mikrotoponim “Gradina”. Në të është konstatuar vendbanimi i gjerë i shekujve II-III, ndërsa më lart edhe gjurmët e kishës së vjetër që mban mikrotoponimin “Kisha e Rimit”. Në areal janë konstatuar dhe mbetje të antikitetit të vonë dhe të mesjetës së hershme, të tjegullave të periudhës bizantine dhe të kishës dhe nekropolit mesjetar. (Emine Kalaja-Hajdari)

LAÇIQI. Fshat kodrinor-malor, rreth 18 km në lindje të Kamenicës. Shtrihet në lartësi mbidetare 650-850 m. Në vitet ‘40 dhe ‘50 të shekullit të kaluar shumë banorë të fshatit

shpërngulen për në Turqi, Shqipëri dhe në Maqedoni. Në vitin 1948 kishte 549 banorë, ndërsa në vitin 2011 u regjistruan 160 banorë. Veprimtaritë kryesore ekonomike janë blegtoria dhe pylltaria. Ka shkollën fillore (deri në klasën e pestë). (Muhamed Kallaba)

LAHAJ Ramë (1983-). Tenor. Lindi në Istog. Shkollimin për t'u profilizuar si tenor e filloi në moshën 21-vjeçare. Në vitin 2014 vazhdoi studimet në Akademinë e Arteve në Tiranë.



RAMË LAHAJ

Nënderkohë punoi drejtor artistik në Radio-televizionin 21 (2009-2011), ndërsa në skenën ndërkombëtare debutoi me rolin e Alfredo Germontit në operën "La Traviata" të Gj. Verdit në Festivalin e 50-të jubilar të Eutinit në Gjermani. Që nga viti 2012 performoi në shtëpi operistike me renome botërore, përfshirë Operën Royal Albert Hall në Londër, në rolin e Rodolfos në "La Boheme" të Gj. Puçinit, pastaj në Operën e Sidenjit në Australi dhe në Operën Kombëtare të Francës. Në rolin e Pinkertonit është paraqitur në operën "Madama Butterfly" të Gj. Puçinit në Gran Teatro del Lago në Itali dhe të njëjtin rol është ftuar ta interpretojë edhe në Operën Las Palmas të Spanjës. Repertori i tij përfshin një mori rolesh, ndër të cilët edhe Dukën e Montovës nga "Rigoletto" e Gj. Verdit dhe Alfredo Germonit nga "La Traviata" po të Gj. Verdit. Është laureat i çmimit "Placido Domingo" në garën operistike më të madhe në botë. Në vitin 2017 R. Lahaj interpretoi Faustin në Operën e Tel Avivit dhe, më pas, bashkë me Placido Domingon është paraqitur në një koncert humanitar në Meksikë. (Besa Luzha)

LAJBNIC Gotfrid (Gottfried Wilhelm Leibnitz) (1646-1716). Filozof, matematikan, diplomat, historian gjerman. Ishte ndër studiuesit e parë që u mor me gjuhën e shqiptarëve. Ai ishte i pari që konstatoi se shqipja kishte një afri me latinishten dhe keltishten dhe i pari që doli me tezën se shqiptarët mund të kenë prejardhje prej ilirëve. Në letrat e shumta që ua drejtoi intelektualëve përmendi shpesh gjuhën e shqiptarëve dhe i luti ata që të mblidhnin të dhëna gjuhësore-historike për këtë gjuhë pak të njohur në atë

kohë. Lajbnici hodhi poshtë mendimin e disa studiuesve të kohës se gjuha e vjetër ilire ka qenë e burimit sllav dhe e mbështeti tezën që relikte të ilirishtes ruhen në gjuhën shqipe. (Milote Sadiku)

LAJÇI Azem (1956-). Kimist, profesor universiteti. Lindi në Pepiç të Pejës. Shkollimin bazë e mori në Zahaq të Pejës dhe në Prishtinë. Studimet i kreu në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore (FSHMN) të Universitetit të Prishtinës (UP) në vitin 1977, ndërsa studimet pasuniversitare dhe tezën e disertacionit e mbrojti në FSHMN të Universitetit të Zagrebit (1986). Në vitin 1984 zgjidhet asistent në FSHMN të UP-së. Në vitet vijuese gradohet në të gjithë titujt universitarë. Ka botuar punime shkencore në revista të ndryshme dhe ka marrë pjesë me kumtesa në tubime shkencore në vend dhe në botën e jashtme. (Salih Gashi)

LAJÇI Bashkim (1955-). Etnolog. Lindi në Pejë. Mbaroi shkollimin fillor dhe të mesëm në vendlindje, ndërkaq studimet për etnologji në Universitetin e Zagrebit. Kreu studimet pasuniversitare në Universitetin e Prishtinës, ndërsa tezën e disertacionit të doktoratës e mbrojti në Tiranë, në Qendrën e Studimeve Albanologjike. Fillimisht punoi në Muzeun Etnologjik të Pejës, ku ishte edhe drejtor. Më pas kaloi me punë në Institutin Albanologjik të Prishtinës, në degën e etnologjisë. U angazhua në mësimdhënie në Universitetin e Prishtinës, në departamentin e etnologjisë dhe të antropologjisë kulturore dhe në Universitetin e Pejës. Ka botuar disa vepra monografike dhe përmbledhje studimesh nga fusha e etnologjisë: "Armët e shqiptarëve gjatë mesjetës" (2006), "Gjurmime etnologjike" (2007), "Syri i keq në besimet shqiptare" (2013) dhe "Tabu në etnokulturën shqiptare" (2014). Ka marrë pjesë me kontribute shkencore në disa konferenca, simpoziume dhe aktivitete të tjera shkencore nga fusha e etnologjisë, organizuar brenda dhe jashtë vendit. (Spresa Siqeca)

LAJÇI Besnik (1971-1999). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), dëshmor. Lindi në Pepaj të Rugovës. Në radhët e UÇK-së u përfshi në nëntor të vitit 1997, në njësitin "Rugova". Mori pjesë në aksione të shumta për furnizim me armatim, por edhe në aksione

kundër armikut. Ishte bashkëthemelues i Shtabit Rajonal të UÇK-së me seli në Pepaj (qershor 1998), e më vonë edhe i Brigadës 136 "Rugova". Ishte komandant i njësitit vëzhgues të kësaj brigade, detyrë që e kreu deri në rënien më 19 prill 1999 në betejën e Qafës së Hajles, në kufirin Kosovë-Mal i Zi, pas luftimeve të zhvilluara edhe në afërsi së bashku me 6 bashkëluftëtarë të tjerë. (Fetnete Ramosaj)

LAJÇI Çun (1946-). Aktor. Lindi në Rugovë të Pejës. Studimet për aktrim i mbaroi në studion e dramës në Teatrin Popullor të Kosovës, ku nga viti 1970 filloi punën si aktor. Realizoi



ÇUN LAJÇI

një sërë rolesh, shumë prej tyre role kryesore. Karrierën e filloi me rolin e Selimit në dramën "Halili e Hajrija", vazhdoi me role të tjera, si Kaligula te "Kaligula", Ademi në "Të ngjuarit", Xheku në "Njerëzit me shpresa të thyera", Pjetri në "Perkolgjinajt", Dijego në "Shtetrrethimi", Karandishevi në "Vajza pa pajë", Suni në "Njeriu i mirë nga Seçuani", kapiteni Lluka në "Ushtari i mirë Shvejk", komisari i panjohur në "Konfiteori", Filenti në "Mizantropi", Rabini në "Verbimi i Samsonit", Xhemail Kada në "No Pasaran", Deli Uka në "Teatri i vogël i Deli Ukës", Tali në "Shpend Sokoli i Sokol Shpendit", Gjenerali në "Ku është populli", Maestro në "Ëndrra e qenit", Ceni në dramën "Përplasjet", Armati në "Komploti ilir", Dr. Fausti në "Doktor Fausti kobzi", Andreu në "Golgota" etj. Por rolet e tij më të realizuara konsiderohet Hamleti në "Hamleti në bodrum" në regji të S. Aleksiqit, rol me të cilin u shpall aktori më i mirë në Festivalin teatror "Joakim Vujiq" në Zrenjanin të Vojvodinës (1972). Për rolin e Maestros në shfaqjen "Hana prej letre" të M. Krajës e në regji të F. Hysajt u shpall aktori më i mirë në Festivalin ndërkombëtar "Kosova In-Fest" në Prishtinë (2007). Edhe në shfaqjen "Grafitet" (2016) dha një kreacion të suksesshëm teatror. Pos në teatër, realizoi një numër rolesh edhe në filmat artistikë, siç janë: "Si të vdiset", "Rojet e mjegullës", "Proka", "Njeriu prej dheut", "Kolonel Bunker", "Kur pranvera vonohet", "Era dhe Lisi", "Përroi vërshues", "Lepuri me pesë këmbë", "Gjurmët e bardha", "Anatema", "Nata e kometës", "Muaji i mjalitit", "Der Albaner",

"Dosja K.", "Falja e gjakut", "Kodi i jetës", "Ag-nus Dei" etj. si dhe rolet në dramën televizive: "Të ngjuarit", "Një jetë e tërë", "Unë, Çe Gevara" etj. Një pjesë të aktivitetit Ç. Lajçi e zhvilloi si artist i pavarur në monodramat e tij "I kujt është ky plis" dhe "Oso Kuka", ku portretizoi me recitime dhe këndim epik figurat kombëtare si Adem Jashari, Oso Kuka etj. Është laureat i një sërë çmimesh dhe mirënjohjesh, ndër të cilët edhe i Urdhrit "Naim Frashëri", i akorduar nga presidenti i Republikës së Shqipërisë. (Fadil Hysaj)

LAJÇI Labinot (1983-). Aktor. Lindi në Pejë, ku kreu shkollimin fillor dhe të mesëm. Studimet për aktrim i kreu në Prishtinë. Luajti në një sërë shfaqjesh në Teatrin e Pejës: "Sfida e madhe", "Atele", "Rrëfimet e narkomanëve", "Memeci që flet", "Vëlla, vëlla, kosi me dollarë", "Varri i qyqes", "Kur loti ngrin në qepallë", "Nata e Helverit" etj.; pastaj në Teatrin e Gjilanit "Orkestra e Titanikut" dhe në Teatrin e Ferizajt në shfaqjen "Atelea". Në Teatrin Kombëtar të Kosovës luajti në shfaqjet "Diana" dhe "Policët", si dhe në disa shfaqje në Teatrin "Dodona", Qendrën Multimedia, Teatrin Alternativ "Qeshu-Smile" etj. Në role të ndryshme luajti në mbi 40 filma të metrazhit të shkurtër, ndër të cilët: "Leonardi", "Kati i pestë", "Tuneli i parë", "Rrota", "Burri", "Kravata", "Piano", "Sonata", "Kthimi", "Teuta" etj. Interpretoi role edhe në disa seriale filmike. Në festivalet vendore mori disa çmime për aktrim. (Bekim Lumi)

LAJÇI Naser (1962-). Inxhinier i makinerisë, profesor universitar. Lindi në Pejë, shkollën fillore e kreu në fshatin Prapaçan, të mesmen në Pejë, ndërsa studimet në Fakultetin Teknik të Universitetit të Prishtinës (UP) (1985). Studimet pasuniversitare i kreu po në Prishtinë, ku mbrojti edhe disertacionin (2006). Në vitin 1987 u zgjodh asistent praktikant në Fakultetin Teknik, më pas avancohet në titullin e ligjëruesit, të profesor-asistentit dhe të profesorit të asociuar (2011). Është autor i disa dispensave për nevoja të studentëve, ndërsa me punime shkencore mori pjesë në simpoziume dhe konferenca shkencore. Është autor punimesh shkencore të botuar në revista të ndryshme. Për nevojat e ekonomisë së Kosovës ka kryer disa projekte të rëndësishme. Është mësimdhënës në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike të Universitetit të Prishtinës. (Musli Bajraktari)

LAJÇI Selman (1954-1999) Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), dëshmor. Lindi në fshatin Ugëll të Peshterit, krahinë e Sanxhakut (Serbi). Kreu Fakultetin e Bujqësisë në Prishtinë, ndërsa studimet pasuniversitare në Zagreb (1990). Punoi në Bankën e Bashkuar të Kosovës në Prishtinë. Në nëntor 1997 u emërua përgjegjës i njësitit “Rugova” të UÇK-së. Udhëhoqi një sërë aksionesh të furnizimit me armë nga Bosnja dhe Shqipëria, përmes territorit të Malit të Zi. Gjithashtu udhëhoqi aksionin për mbrojtjen e Shtupeqit të Madh nga sulmet e ushtrisë e policisë serbe (24 gusht 1998). Organizoi dhe udhëhoqi ndihmën për mijëra të zhvendosur nga vendbanimet e Dukagjinit, si dhe organizoi përcjelljen nëpër Rugovë të 400 luftëtarëve të Zonës Operative të Shalës, që vinin nga Shqipëria. Zbatoi me sukses detyrat për bartjen e më shumë se 40 të plagosurve nga Shqipëria dhe Dushkajës deri në Rugovë, në prill të vitit 1999. Mbikëqyri pikat Qafë e Hajles, Qafë e Qyqes, Drelaj dhe Kuqishtë dhe mori pjesë në betejat në grykën e Rugovës, në Albë të Vogël, Baran, Gërgoc, Ozdrim etj. Ra dëshmor në betejën e Qafës së Hajles më 19 prill 1999, pas luftimeve të rrepta me forcat serbe. (Faton Mehmetaj)

LAJÇI Shpëtim (1977-). Inxhinier i makinërisë, profesor universiteti. Lindi në Deçan, ku kreu shkollën fillore dhe gjimnazin. Studioi në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike të Universitetit të Prishtinës (UP). Më 2013 doktoroi në Universitetin e Mariborit (Sloveni). Në vitin 2003 u zgjodh asistent në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike të UP-së dhe më pas mori titujt përkatës universitarë për një sërë lëndësh nga kjo fushë. Ndërkohë, ka ndjekur trajnime, seminare, specializime dhe hulumtime në shumë vende të Bashkimit Evropian. Është autor i disa punimeve shkencore dhe profesionale, i kumtesa dhe i ligjërata të autorizuara. Është bashkautor i librit “Suspension System Design of the Modern Terrain Vehicles” (Dizajni i sistemit të pezullimit të automjeteve moderne të terrenit) (2014). (Musli Bajraktari).

LAJMËTARI I PIRANËS. Shtatore miniaturë parahistorike, e zbuluar rastësisht rreth lokalitetit “Qeremide” në Piranë, rreth 11 km në verilindje të Prizrenit. Paraqet figurën e mashkullit të derdhur në bronz, i cili dorën e djathtë e mban te veshi, derisa dorën e majtë e mban në bark. Si e tillë, mund të ketë qenë

pjesë dekoruese e ndonjë ene. Mendohet se i takon shek. V-IV p.e.r. Shtatorja është njëri nga artefaktet arkeologjike më të rëndësishme të rajonit të Prizrenit dhe më gjerë, duke qenë unike e llojit të vet dhe pa analogji deri më sot. (Milot Berisha)

LAJTHIA. (*Corylus avellana* L) Shkurre e familjes mësh teknore (*Betulaceae*), e lartë 5-7 m, mjaft e shpeshtë e pyjeve tona gjetërenëse, kurse optimumin jetësor e arrin në zonën e ahut kodrinor. Lëvoren e ka të murrme e të lëmuar, me gjethe të rrumbullakëta, pak eliptike në fund, në trajtë zemre, buzë dhëmbëzuara e me bisht të shkurtër. Lulet mashkullore janë të vendosura në lulesa levare të gjata deri në 8 cm. Dimërojnë dhe lulëzojnë para gjetësisimit, shpesh në fund të shkurtit e në fillim të prillit. Lulesat femërore (dikazet) janë dylulesh në formë sythi, prej nga, në kohën e pjalmimit (shkurt-mars), dalin dy krezat të gjata të kuqërremta të pistilit dykarpelar. Fryti arrëz i futur në një qese (kupullë) piqet në vjeshtë dhe përmban rreth 50-60% materie yndyrore. Përdoret për ngrënie, për gatimin e ëmbëlsirave dhe nxjerrjen e vajit. Në pyjet gjetërenëse me hije të Kosovës është e përhapur edhe lajthia e egër, lajthia e arushës (*Corylus colurna* L.), dru i lartë deri 25 m, që jeton deri në 200 vjet. (Feriz Krasniqi)

LAKE Susan (1962-). Balerinë nga Britania e Madhe. Lindi në Uells. Në trupën e baletit në Teatrin Popullor Krahinor, për disa vjet u angazhua në projekte të shumta skenike, përkatësisht shfaqjet e baletit. U dallua me rolin e saj të Nënës në shfaqjen “Legjenda mbi ngadhënjimin” të kompozitorit Rexho Mulliqi (1981), pastaj atë të Vanilldës në shfaqjen “Kopelia” të Leo Delibit (1982) dhe në shfaqje të tjera. (Arian Krasniqi)

LALAJ Ana (1952-). Historiane. Lindi në Tiranë. Shkollën fillore, të mesme dhe studimet për histori i kreu në Tiranë. Nga viti 1979 u zgjodh punonjëse shkencore në Institutin e Historisë në kuadër të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Ishte drejtore e Institutit të Historisë në vitet 1998-2005 dhe pedagoge e jashtme në Universitetin e Tiranës dhe në Universitetin e Durrësit. Kreu specializime në SHBA, Britani, Hungari, Norvegji dhe Poloni. Merret kryesisht me historinë e re të Kosovës dhe të

Shqipërisë gjatë periudhës së Luftës së Ftohtë. Është autore e dy monografive shkencore: "Lufta për vetëvendosje e popullsisë shqiptare në Jugosllavi gjatë viteve 1941-1945" (1984), dhe "Kosova: Rruga e gjatë drejt vetëvendosjes, 1948-1981" (2000). Botoi dy përmbledhje studimesh të shoqëruara me dokumente të publikuara për herë të parë: "Dosjet e luftës" (2014) dhe "Pranvera e rrejtshme e '56-s" (2015). Ka botuar edhe një sërë artikujsh në revista dhe në përmbledhje studimesh dhe ka marrë pjesë në konferenca shkencore brenda dhe jashtë vendit. (Frashër Demaj)

LAMA E ARTË, NOVOBËRDË. Vendbanim i fortifikuar parahistorik, i vendosur mbi një kodër të butë. Gjendet në kompleksin e xehoreve, pranë lagjes së minatorëve "Kolonja". Ka trajtë elipsoide të çrregullt (4 ha) dhe ledhe dheu që ndjekin izohipsën më të lartë të kodrës. Në anën veriore gjendet trakti i murit rrethues (25 x 1.60 m), i ngritur nga gurë të mëdhenj e mesatarë. Muri përforcohej nga brenda me kontraforë në çdo 3.90 m. Duket se vendbanimi është shtrirë edhe në anën lindore e perëndimore të kodrës. Në të janë zbuluar zgjura, fragmente vazosh me figura të zeza (shek. VI p.e.r.), fragmente të amforave, si dhe terakota e hyjneshës Hygia dhe koka e bronzit e meduzës Gorgona (shek. IV-III p.e.r.). Sipas E. Çershkov, në afërsi janë zbuluar rastësisht disa varre me qeramikë helenistike, enë metalike dhe terakota, njëra e hyjneshës Kibella. Vendbanimi i takon fazës paraurbane dardane (shek. VI-IV) dhe asaj urbane dardane (shek. IV-III p.e.r.). (Haxhi Mehmetaj)

LAMA Fatmir (1944-). Regjisor televiziv. Lindi në Gjakovë, ku kreu shkollën fillore, ndërsa gjimnazin e kreu në Gjakovë dhe në Pejë. U diplomua në Prishtinë në studion dyvjeçare të dramës. Pas një përvoje të shkurtër aktrimi, një kohë punoi si asistent i regjisë në Televizionin e Zagrebit, më pas u kthye në Televizionin e Prishtinës (TVP), ku punoi në regji televizive deri në vitin 1990, deri në mbylljen e TVP-së nga Serbia. Në TVP bëri regjinë e emisioneve dokumentare dhe të transmetimeve të drejtpërdrejta të manifestimeve të ndryshme, spektakleve artistike, emisioneve në studio, ngjarjeve sportive etj. Ishte njëri nga regjisorët e transmetimit për rrjetin botëror televiziv të Lojërave Olimpikë të Sarajevës (1984). Pas

luftës në Kosovë punoi në TV "Kohavision", ku u mor kryesisht me emisione televizive dokumentare. (Nehat Islami)

LAMA Kudusi (1951-). Ushtarak i Ushtrisë së Shqipërisë, pjesëmarrës i luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Lindi në fshatin Gështenjë të Kalisit, në krahinën e Lumës,



KUDUSI LAMA

rrethi i Kukësit. Më 1972 kreu Shkollën e Bashkuar të Oficerëve në Tiranë. Nga ajo kohë kreu detyra të rëndësishme ushtarake në Shqipëri. Në vitin 1996 mbrojti disertacionin e doktoratës dhe mori gradën doktor i shkencave ushtarake. Në vitin 1997 mori gradën gjeneral brigade. Në periudhën 1997-1999 ishte komandant i Divizionit të Këmbësorisë në Kukës, ndërsa në vitet 2000-2006 ishte komandant për logjistikë i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Në luftën çlirimtare të Kosovës u angazhua që në maj të vitit 1997 dhe vijoi deri në përfundimin e saj. U angazhua në shumë veprimtari bashkëpunimi me Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së, kryesisht në fushën e organizimit, të planëzimit, të trajnimit, të furnizimit, të akomodimit e deri te pjesëmarrja e drejtpërdrejtë në vijat e frontit. Ka merita të veçanta për sukseset e betejave të zhvilluara nga UÇK-ja, për thyerjen e kufirit Shqipëri-Kosovë në Dukagjin dhe Pashtrik. Është autor i një sërë librash publicistikë dhe profesionalë, ndër të cilët: "Kosova dhe Ushtria Çlirimtare" (2005), "Hyrje në menaxhimin e emergjencave" (2012), "Menaxhimi i emergjencave" (2013) etj. (Fetnete Ramosaj)

LAMBERC Maksimilian (Maximilian Lamberg) (1882-1963). Gjuhëtar austriak, albanolog, indoeuropianist. Lindi në Vjenë, ku edhe u shkollua, duke studiuar gjuhësi krahasuese e



MAKSIMILIAN LAMBERCI

klasike, filologji e arkeologji. U doktorua në Universitetin e Vjenës. Bashkëpunoi në Enciklopedinë e gjuhës latine në Munih. Ndërmori vizita studiuuese në Italinë e Jugut lidhur me të folmet arbëreshe. Më

vonë vizitoi disa herë Shqipërinë. Në vitin 1916 u zgjodh anëtar i Komisionit Letrar. Më 1939 u kthye në Mynih për të vazhduar punën në enciklopedinë e përmendur, deri më 1942. Më 1945 zgjidhet drejtor i shkollës së gjuhëve të huaja në Lajpcig, profesor i gjuhësisë krahasuese, dekan i Fakultetit të Arsimimit të ri të Lajpcigut dhe drejtor i Institutit të Studimeve Indoeuropiane, deri në pension. Shqipërinë e vizitoi sërish më 1954 dhe 1957. Veprimtaria shkencore e M. Lamercit përfshin kërkimet dialektologjike, sidomos në Shqipëri, por edhe në kolonitë arbëreshe në Itali të Jugut dhe në Greqi. U mor me studimin e folklorit. Veprat e tij kryesore janë: “Periudha hipotetike në gjuhën shqipe” (1914/15); “Përralla shqiptare dhe të tjera tekste të folklorit shqiptar” (1922); “Midis Drinit e Vjosës”; “Përralla prej Shqipërie”; “Gjergj Fishta dhe epi heroik shqiptar ‘Lahuta e Malcis’”; “Një hyrje në botën e legjendave shqiptare” (1949); “Epika popullore shqiptare” (1958) etj. Gjithashtu është autor i një monografie për këngët kreshnike, i fjalorit gjermanisht-shqip, ndërsa bëri përkthimin gjermanisht të “Lahutës së Malcis” etj. (Mensur Vokri)

LAMÇE Sami (1917-1978). Veprimtar i arsimit, mësimdhënës. Lindi në Starovë të Pogradecit, ku kreu edhe shkollimin fillor. Shkollimin e mesëm e filloi në Shkollën Teknike Amerikane të Tiranës, për të vazhduar në Normalen e Elbasanit, të cilën e kreu në vitin 1940. Fillimisht punoi si mësues në disa shkolla të Pogradecit, më pas si mësimdhënës në paralelet shqipe të Shkollës normale “Nikolla Karev” të Shkupit, ndërsa me hapjen e Normales “Liria” në Tetovë (1950/51), S. Lamçe emërohet mësimdhënës i biologjisë. Punoi me zell dhe me përkushtim për arsimin e mësuesve shqiptarë. Për shkak të bindjeve dhe aktivitetit të tij atdhetar, u pezullua nga puna në Maqedoni dhe u detyrua të zhvendoset në Kosovë (Skënderaj), pastaj në Dibër të Madhe dhe prej atje u kthye në Shqipëri. (Fadbi Osmani)

LAMOJA Nafije (1939-). Spikere e Radio Prishtinës. Lindi në Tiranë. Shkollën fillore dhe shkollën normale i kreu në Prishtinë. Punoi mësuese deri në vitin 1964 në shkollën fillore “Emin Duraku” të Prishtinës. Nga ky vit punoi në Radio Prishtinë, kryesisht spikere e lajmeve, folëse dhe moderatore emisionesh të

ndryshme, derisa Serbia me masat e dhunshme i largoi punëtorët shqiptarë nga puna (1990). (Ibrahim Berisha).

LANDOVICA. Fshat në komunën e Prizrenit, 7.5 km në veriperëndim të qytetit. Është vendbanim i vjetër, që dëshkohet me gjetje të ndryshme arkeologjike. Ndodhet në të dy anët e rrugës Prizren-Gjakovë. Nëpër fshat kalon hekurudha, e cila lidh Prizrenin me Klinën. Gjendet në lartësi mbidetare 310-380 m. Sipërfaqja e vendbanimit është 974 ha, me një pjesë të madhe të tokës që shtrihet në rrafshin aluvial të Drinit të Bardhë. Midis dy luftërave botërore këtu u vendosën kolonë serbë. Në regjistrimin e vitit 1948 fshati kishte 312 banorë, kurse në vitin 2011 ishin të pranishëm 1,149 banorë. Gjatë luftës së fundit, 80% e fshatit u dogj dhe shumë banorë u vranë. Popullsia merret kryesisht me bujqësi. Pjesa më e madhe e sipërfaqeve është bujqësore dhe është e përfshirë në sistemin e ujitjes. Një pjesë e sipërfaqes është e mbuluar me vreshta. Në afërsi të vendbanimit gjenden rezerva të argjilës, e cila tradicionalisht është përdorur për prodhimin e materialit ndërtimor. (Valbon Bytyçi)

LATERKULI I CERCËS. Pllakë argjile me mbishkrim i periudhës së antikës së vonë. U zbulua në fshatin Cercë të Istogut (2005). Ruan mbishkrim në gjuhën latine, të shkruar me dorë të lirë (0.26 x 0.26 x 7 cm). Të dhënat epigrafike të pllakës pasqyrojnë aktin e inaugurimit të banjës romake të quajtur Labanon, përkatësisht Albanon. Bazuar në të dhënat paleografike dhe analogjitet, laterkuli i Cercës i përket periudhës së antikitetit të vonë. Ruhet në Institutin Arkeologjik të Kosovës. (Arben Hajdari)

LATIFI Afrim (1975-). Karateist. Lindi në Prishtinë. Kreu studimet në Fakultetin e Shkencave Sportive. Filloi të merret me karate që në moshën 12 -vjeçare, së pari në KK “Prishtina”, kurse nga viti 1992 bëhet anëtar i KK “Besa Impex”. Gjatë karrierës së tij aktive u bë kampion i shumëfishtë i Kosovës në kategorinë e rëndë dhe në kategorinë absolute. Pas vitit 2000 bëhet anëtar i përfaqësueses së Shqipërisë. Fitoi titullin e kampionit të Europës në Gjermani (2003), medaljen e bronzit në Europeanin e vitit 2003 po në Gjermani, është kampion i dyfishtë i Ballkanit në Novi-Sad

(2003), fitues i turneut të tetë i më të mirëve të botës në Zagreb (2003), kampion i Ballkanit në Greqi (2004) etj. Jeton dhe vepron në SHBA. (Lulzim Shala)

LATIFI Driton (1978-). Gazetar i sportit. Lindi në Prishtinë. Shkrimet e para në gazetari sportive i pati në gazetën “Sport plus” në vitin 1995. Nga viti 1999 filloi të punonte në gazetën e përditshme “Koha ditore” në Prishtinë. Më vonë kreu edhe detyrën e redaktorit në këtë gazetë. Nga viti 2003 kaloi në gazetën “Lajm”, kurse nga viti 2007 punoi në RTV 21. Në “Lajm” punoi deri në vitin 2010, kurse nga viti 2011 ishte redaktor në gazetën e përditshme “Zëri” në Prishtinë deri në vitin 2013. Gjatë punës si gazetar sportiv ka intervistuar shumë personalitete të njohura të sportit. Ka ndjekur gara dhe ndeshje të shumta vendore dhe ndërkombëtare. (Edmond Thaçi)

LATIFI Muhamet (1955-). Veprimtar, komandant i Mbrojtjes Civile në Zonën Operative të Llapit. Lindi në fshatin Pollatë të komunës së Podujevës. Përfundoi studimet në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës. Ishte aktiv në organizimet ilegale të lëvizjes së rezistencës për Republikën e Kosovës gjatë viteve '80, për çka u arrestua dy herë. Gjatë viteve '90 u angazhua për krijimin e institucioneve paralele, për çka u mbajt në burg në vitet 1994 dhe 1997. Nga viti 1997 vuri kontakte me strukturat e organizuara të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) dhe u përfshi në radhët e saj. Nga viti 1998 u emërua anëtar i shtabit të kësaj zone dhe komandant i Mbrojtjes Civile. Pas luftës u angazhua në ndërtimin e strukturave civile-policore dhe ushtarake të Kosovës. (Ismet Cakiqi)

LATIFI Mulla Hysen (1908-1993). Titullar i fesë islame. Lindi në fshatin Përlepnice, afër Gjilanit. Mësimet e para i mori te hoxha i fshatit e pastaj në Gjilan, ndërsa shkollimin e mesëm e kreu në Medresenë e Isa Begut në Shkup. Studime i vazhdoi në Universitetin “Al-Azhar”, në Kajro (1943). Ardhja e komunistëve në pushtet në Kosovë i pamundësoi kthimin në vendlindje. Një kohë punoi si përkthyes dhe më 1950 u shpërngul në Mekë, ku punoi si mësimdhënës deri në vitin 1973. Nga Meka transferohet imam në Qendrën Islamike në Bruksel, ku shërbeu deri më 1980. Kur mërgata

shqiptare në Bruksel themeloi Qendrën Islame Shqiptare, H. Latifi u emërua udhëheqës i saj. Dha kontribut të çmuar që Qendra Shqiptare Islame në Bruksel të shndërrohej në vatër të rëndësishme të mërgatës shqiptare. (Qemajl Morina)

LATIFI Rifat (1955-). Mjek, kirurg, profesor universiteti. Lindi në Kllodernicë të Skënderajit. Shkollën fillore e përfundoi në Turiqec, ndërsa shkollën e mesme të mjekësisë në



RIFAT LATIFI


Prishtinë. Në vitin 1982 i përfundoi studimet në Fakultetin e Mjekësisë dhe po atë vit emigroi në SHBA. Fillimisht u vendos në Hjuston, ku punoi në hulumtime shkencore. Specializimin për kirurgji e filloi në Klinikën e Klivlendit, pastaj e vazhdoi në Universitetin e Jelës, ndërsa specializimin në traumatologji e kreu në Nju-Jork. U bë profesor 5 vjet pas mbarimit të specializimit dhe mbajti shumë poste akademike dhe organizative me rëndësi. Vazhdoi të punojë me përkushtim në afirmimin dhe avancimin e shëndetësisë shqiptare. Kontributi i tij është i madh në themelimin e shërbimit të telemjekësisë në Kosovë dhe në Shqipëri. Si ekspert në lëmin e kirurgjisë, përveç në universitete të ndryshme amerikane, për një kohë punoi edhe në Katar dhe vende të tjera. Në qendrat ku punoi u angazhua edhe në edukimin e mjekëve shqiptarë. Është autor/editor i 12 botimeve profesionale në kirurgji, nutricion, laparoskopji dhe telemjekësi. Jeton dhe vepron në SHBA. (Ismajl Dreshaj)

LATIFI Skënder (1967-). Gazetar. Lindi në fshatin Kurbali të Karadakut të Preshevës. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Preshevë, ndërsa Shkollën e Lartë të Makinerisë në Ferizaj. U mor me letërsi dhe publicistikë. Botoi romanet “Dhjetë rrëfime për një tradhti” dhe “Profetët e rrejshëm”, si dhe librat publicistikë “Kosova Lindore në dritën e shifrave dhe fakteve”, “Rrugëtimi nëpër Luginë të Preshevës” dhe librin e bashkëbisedimit me Ali Aliun, “Përtej ferrit” (2008). Në fillim të viteve '90 të shekullit të kaluar filloi të merrej me gazetari, si korrespondent nga Presheva për mediet në gjuhën shqipe në Maqedoni dhe në Kosovë.

Punoi si korrespondent i të përditshmeve “Fakti” dhe “Rilindja”. Bashkëpunoi edhe me të përjavshmen “Zëri” (2001-2005) të Prishtinës dhe me disa medie ndërkombëtare, IWPR, Radio “Dutsche Welle” (2000-2006) etj. Ishte kryeredaktor i Radiotelevizionit të Preshevës (2005-2006). Përktheu në shqip edhe një sërë veprash nga fusha e publicistikës politike. Nga viti 2006 jeton në Belgjikë. (Zija Rexhepi)

LATIFI Shaip (1948-). Inxhinier i xehetarisë. Lindi në fshatin Majac të Podujevës, arsimin bazë e mori në Podujevë, ndërsa studimet i kreu në Fakultetin e Xehetarisë të Tuzllës (Bosnjë e Hercegovinë) (1972). Punoi në minierat e “Trepçës” në Hajvali, Kishnicë dhe Novobërdë, si udhëheqës i galerisë, kurse më pas drejtor teknik i saj (1976). Në vitin 1982 ishte pjesëmarrës i projektit për përparimin e teknologjisë së minierës, të kryer nga Instituti “Atlas copko” (Suedi) dhe Universiteti i Klaustalit (Gjermani). Kalon me punë në minierën e Goleshit, si kryetar i shtabit të krizës, e cila u shkaktua nga protestat e minatorëve të vitit 1988. Pas këtyre ngjarjeve, në vitin 1989 migroi në Zvicër, ku u përfshi në aktivitete politike të diasporës. Për shumë vjet ishte kryetar i degës së Lidhjes Demokratike të Kosovës në Zvicër. Pas vitit 1999 në dy mandate ishte anëtar i bordit i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale. (Izet Zeqiri)

LATIFI Vesel (1942-). Jurist, profesor universitar. Lindi në Zajçec të Kamenicës, shkollimin fillor, të mesëm dhe Fakultetin Juridik i kreu në Prishtinë, magjistroi në Universitetin e Lubjanës, ndërsa doktoroi në Universitetin e Prishtinës. Fillimisht punoi gjyqtar i Gjykatës Komunale në Prishtinë. Kreu edhe funksione të tjera të nivelit komunal dhe krahinor të periudhës së autonomisë së Kosovës. Është profesor



VESEL LATIFI

i rregullt për lëndën e kriminalistikës. Në vitin 1993 ka mbajtur ligjërata tematike në Universitetin “Fridrih Schiller” të Jenës në Gjermani. Ishte aktiv në disa shoqata dhe asociacione. Në periudhën 1991-1995 punoi si avokat i licencuar. Ishte kryeredaktor i revistës “E drejta” dhe kreu edhe funksione të tjera në institucionet e

arsimit të lartë. Gjatë vitit 1999-2000 ka qenë anëtar i Komisionit Teknik Këshillëdhënës për Gjyqësi dhe Prokurori në kuadër të UNMIK-ut, ndërsa në vitet 2007-2009 kryetar i Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës. Përveç kriminalistikës, ka ligjëruar edhe lëndët politika kriminale dhe rendi dhe siguria publike. Botoi disa tekste universitare: “Kriminalistika” (1984), “Kriminalistika e delikuencës së të miturve” (1985), “Politika kriminale” (1987) etj. (Ejup Sahiti)

LATIFI-BERISHA Hamide (1960-). Gazetare, aktiviste në shoqërinë civile. Lindi në Prugoc të Prishtinës. Shkollimin fillor dhe të mesëm i kreu në Prishtinë, studimet në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës. Punoi gazetare në të përditshmen “Rilindja” dhe më pas në “Bujku”. Krahas gazetarisë, u angazhua edhe në Shoqatën humanitare “Nënë Tereza” gjatë periudhës 1990-1999. Pas luftës, nga viti 2000, punoi veprimtare e shoqërisë civile, për rindërtimin e vendit, me fokus në zhvillimin dhe fuqizimin ekonomik të grave dhe nxitjen e pjesëmarrjes së tyre aktive në proceset shoqërore. Për punën e saj në fushën e gazetarisë u nderua me çmim për gazetari të guximshme nga Human Rights Watch-Hellman Hammett Grants (2000). Kuvendi i Kosovës e nderoi me mirënjohje për punën e saj në fushën e fuqizimit ekonomik të grave (2014). (Artan Krasniqi)

LATINËT. Kategori fetare, social-ekonomike dhe etnike mesjetare. Burimet mesjetare kanë lënë fushë të gjerë për kuptimin e këtij nocioni. Dëshmia më e vjetër e emrit, e kategorisë fetare dhe etnike latine në kontekst të historisë së Kosovës gjatë mesjetës, paraqitet në kartën e Shën Gjergjit në Shkup (1330). Një përmbajtje pothuajse identike, po nga kjo kohë, e ndeshim edhe në kartën e Zojës Prene në Prizren, ku përmenden *greku* dhe *latini*, që në këtë rast kanë kuptim fetar dhe etnik. Në anë tjetër, po në Prizren dhe rrethinë, sipas kartës së Shenjtorëve Mëhill dhe Gabriel, emri latin do të paraqitet si kategori social-ekonomike dhe fetare njëkohësisht. Së këndejmi, shqiptarët e rrethinave të Prizrenit i ndeshim si bujq, blegtorë, derisa murgu i tyre ishte latin, përkatësisht katolik. Tregtarët latinë i ndeshim në qendra të ndryshme të Kosovës, por edhe gjetiu. Latinët e Kosovës i ndeshim edhe në disa

nene të Kodit të Dushanit (118-121, 153, 1599-160). Në dokumentet e burimeve perëndimore (të Papatit, Raguzës, Venedikut, Kotorrit etj.) nocioni latin ndeshet në radhë të parë si kategori fetare, më pastaj edhe si kategori tregtare, madje, janë përdorur në mënyrë të alternuar nocionet latin dhe raguzan, latin dhe venedikas etj. Në përdorim të përditshëm emërtimi përdorej për t'i diferencuar katolikët nga pjesëtarët e religjionit ortodoks. Po në këtë kuptim është përdorur edhe në oborrin papnor për zonat e kontaktit me grekët dhe sllavët. (Jahja Drançolli)

LATRONËT DARDANË. Kryengritës dardanë, të cilët u shfaqën për ta kundërshtuar sundimin romak. Politikat romake të shfrytëzimit dhe luftërat e gjata kundër pushtimeve të tyre krijuan pakënaqësi dhe kundërshtim nga popullsia vendore dhe sollën krijimin e latronëve apo cubave dardanë (latrones dardanici). Latronët u bënë rrezik i përhershëm për qetësi në provincën e Mezisë, andaj romakët u detyruan që të vendosnin në Dardani rrjetin më të dendur të stacioneve beneficiare. Mbështetur në dëshmitë epigrafike, epiqendra e rezistencës dardane ishte Rrafshi i Dukagjinit dhe lugina e Timokut. Rreziku nga kjo lëvizje bëri që perandori Mark Aurel të ndërmarre hapa për shuarjen e saj, duke krijuar dhe dy njësi ushtarake (Cohors I et II Aurelia Dardanorum), të përbëra kryesisht nga latronët (169). Stelat e shek. III nga Zllakuqani dhe Rahoveci, të dedikuara të vrarëve nga latronët, dëshmojnë se lëvizja latrone nuk u shua plotësisht, përkundër masave që ndërmoi Mark Aureli. Prezenca e latronëve është e dëshmuar nga burimet epigrafike. (Emine Kalaja-Hajdari)

LAUKA Islam (1954-). Diplomat, politolog. Lindi në Bytyç të Tropojës. Arsimin fillor e kreu në vendlindje, ndërsa arsimin e mesëm dhe të lartë në Tiranë. Fillimisht punoi mësues në disa fshatra të Tropojës dhe, më vonë, drejtues i rinisë po në këtë rreth. Më 1985 filloi punë në Ministrinë e Punëve të Jashtme, ku kreu disa funksione me rëndësi. Më pas shërbeu sekretar i parë dhe i Ngarkuar me Punë në Ambasadën e Shqipërisë në Moskë dhe Ambasador i Shqipërisë në Kosovë. Më 1994, në Akademinë Diplomatike të Moskës mbrojti doktoratën me temë, "Evolucioni i

problemit të Kosovës dhe gjendja e tij aktuale". Gjithashtu ka botuar disa libra mbi Kosovën, si: "Kosova, rast universal apo sui generis" (2007, përkthyer anglisht, arabisht dhe rumanisht), "Shkëputja e Kosovës nga Rusia" (2007), "Kosova e pavarur ose dështimi i kryqëzatës ruso-serbe" (2011), ndërsa është bashkautor i librave "Shqipëria në arkivat ruse" (2006) dhe "Antologjia e kryqëzimit" (2012). Ka marrë pjesë me kumtesa në konferenca shkencore ndërkombëtare kushtuar çështjes së Kosovës. (Fehmi Rexhepi).

LECI Mustafë (1948-). Gazetar i sportit. Lindi në Martinaj të Plavës, Mali i Zi. Shkollën normale e mbaroi në Pejë, ndërsa Fakultetin Filozofik, degën e pedagogjisë dhe të psikologjisë, në Prishtinë. Punoi si gazetar i sportit në gazetën e përditshme "Rilindja" që nga viti 1974 e deri në mbyllje të saj. Pos me këtë të përditshme, M. Leci ka bashkëpunuar edhe me shumë revista dhe gazeta sportive. Gjatë periudhës 1991-1999 ishte anëtar i redaksisë së revistës "Refleksi sportive" dhe më pas edhe "Top sporti", ku ka botuar shumë shkrime, analiza, intervista, komente etj. (Ejup Llumnica)

LECI Osman (1943-). Kimist, profesor universiteti. Lindi në fshatin Barilevë të komunës së Prishtinës. Shkollimin bazë e kreu në vendlindje dhe në Prishtinë. Studimet i kreu në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës (UP), në degën e kimisë (1967). Studimet pasuniversitare i përfundoi në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore (FSHMN) të Universitetit të Zagrebit (1972). Tezën e disertacionit e mbrojti në FSHMN të UP-së në vitin 1979. Në vitin 1970 u zgjodh asistent në degën e kimisë në FSHMN të UP-së dhe në vitet vijuese i arrin të gjithë titujt universitarë. Ligjëroi disa lëndë nga kimia organike dhe biokimia. Ka publikuar punime shkencore në disa revista dhe ka marrë pjesë me kumtesa në tubime shkencore ndërkombëtare dhe vendore. Është specializuar në disa universitete të Europës. Është autor i disa tekste shkollorë dhe ka udhëhequr projekte të ndryshme shkencore. (Salih Gashi)

LEGJIONET ROMAKE. Njësi ushtarake të antikitetit të përbëra nga rekrutë me shtetësi romake. Legjionet në periudhën e Republikës

romake fillimisht përbëheshin nga 5 mijë trupa, duke përfshirë edhe kalorësinë. Këta kishin për detyrë ruajtjen e kufijve dhe të transaksioneve tregtare në provincat romake. Në Ballkan lëvizjet e legjioneve romake dëshmojnë vetëm pas shtypjes së revoltës trake të vitit 11 p.e.r. Legjionet e para romake ishin: Legjioni IV Skit, i formuar në vitin 42 p.e.r. nga triumviri Mark Antoni dhe i vendosur në Sirmium (Mitrovica e Sremit) dhe Legjioni V maqedon, i formuar në vitin 43 p.e.r. nga Augusti dhe i vendosur në Maqedoni nga viti 30 p.e.r. deri në vitin 6, pastaj në Mezinë e Epërme në Oescus te Plevni i sotëm në Bullgari (6-62, 70-101, 274-shek. V), në Troesmis dhe në Turda të Rumanisë (107-161, 166-274). Në Mezinë e Epërme, ku bënte pjesë dhe Kosova antike, ishin vendosur dy legjione në vitin 125: Legjioni IV Flavia Felix, i vendosur në Singidunum dhe Legjioni VII Claudia Pia Fidelis, i vendosur në Viminacium (Kostolac), i formuar nga Pompei (65 p.e.r.). Claudia VII i ka shërbyer perandorit Mark Aurel Klaudit për 10 vite në luftërat te Danubi. Legjioni VII Kludia është dëshmuar në shumë mbishkrime në gjithë arealin e Kosovës. (Arianit Buçinca)

LEGJISLACIONI / RREGULLORET E UNMIK-ut (1999-2006). Sistem juridik i vendosur nga Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), i bazuar në rregulloret dhe udhëzimet administrative të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSPP) të OKB-së. Nga viti 1999-2002 rregulloret e UNMIK-ut kishin fuqinë ligjore, kurse nga viti 2001 Korniza Kushtetuese kishte fuqinë "kushtetuese". Gjatë periudhës së parë 1999-2002 rregulloret i fuqizonte vetë PSSP-ja, ndërkaq pas krijimit të institucioneve të përkohshme vetëqeverisëse të Kosovës, pos rregulloreve të UNMIK-ut, zbatoheshin edhe ligjet e Kuvendit të Kosovës, por pas dekretimit nga ana e PSSP-së. Deri në funksionimin legjislativ të Kuvendit të Kosovës, në periudhën 1999-2003 ishin në fuqi 225 rregullore të UNMIK-ut. Numri i rregulloreve të PSSP-së pakësohej sa më tepër që konsolidohej Kuvendi i Kosovës (nga 69 sa ishin nxjerrë në vitin 2000, në vetëm 17 në vitin 2003). Por edhe pas konstituimit të Kuvendit të Kosovës, PSSP-ja vazhdoi të nxirrte rregulloret për fushat e kompetencës së tij ekskluzive, kështu që vetëm gjatë vitit 2005 kishte nxjerrë 48 rregullore.

Rregulloret e UNMIK-ut, pasi propozoheshin nga PSSP-ja, pas vlerësimit për nevojën e rregullimit ligjor të një fushe, draftoheshin në zyrën ligjore të OKB-së në Nju-Jork, ktheheshin te Këshilli i Përbashkët për Çështje Legjislative i UNMIK-ut për të marrë këndvështrimin e vendorëve dhe pastaj nënshkruheshin nga PSSP-ja dhe botoheshin në Fletoren zyrtare të UNMIK-ut. (Blerim Reka)

LEGJISLACIONI I KOSOVËS (1990-1999). Aktet juridike, të cilat Kosova i ka nxjerrë për të rregulluar pozitën e saj, pas procesit të shpërbërjes së ish-Jugosllavisë, në përputhje me të drejtën për vetëvendosje. Duke u përfshirë në proceset politike që lindën me shpërbërjen e ish-Jugosllavisë, edhe populli shqiptar, si një nga popujt numerikisht më të mëdhenj të Jugosllavisë (i treti për nga numri i banorëve), nëpërmjet organeve të veta legjitime (Kuvendit) dhe me vetëpërcaktim gjithëpopullor (referendum) shprehu vullnetin dhe të drejtën natyrore që të jetë i lirë dhe i mëvetësishëm në përcaktimin e statusit të vet kushtetues dhe politik. Legjislacioni i Kosovës në këtë periudhë bazohej në: Deklaratën Kushtetuese të 2 Korrikut të vitit 1990; Kushtetutën e Republikës së Kosovës të 7 shtatorit të vitit 1990 (Kushtetuta e Kaçanikut); Referendumin gjithëpopullor për Kosovën shtet sovran dhe i pavarur, të mbajtur më 26-30 shtator të vitit 1991; Rezolutën e Kuvendit të Kosovës për Kosovën shtet sovran dhe i pavarur, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 19 tetor 1991; amendamentet kushtetuese në Kushtetutën e Republikës së Kosovës të miratuara nga Kuvendi i Kosovës më 19 tetor 1991, të cilat Kosovës i realizuan qëllimet për mëvetësi dhe organizim të pavarur politik me ligjet e saj. (Arsim Bajrami)

LEGJISLACIONI I KSA TË KOSOVËS (1945-1989). Tërësia e të gjitha akteve ligjore dhe nënligjore që rregullonin marrëdhëniet shoqërore të Kosovës, në kuadër të ish-Jugosllavisë. Varësisht nga fazat e zhvillimit të pozitës kushtetuese ndryshonin edhe kompetencat legjislative me të cilat rregulloheshin marrëdhëniet politike, ekonomike, sociale, arsimore e kulturore të Kosovës. Autonomia legjislative determinohej nga autorizimet e Krahinës Socialiste Autonome (KSA) të Kosovës, të cilat buronin varësisht prej pozitës kushtetuese në

faza konkrete të zhvillimit të saj brenda federalizmit jugosllav. Legjislacionin e KSA të Kosovës në fazat e para brenda ish-Jugosllavisë e përbënin: statutet, vendimet, aktvendimet, rregulloret, udhëzimet etj., të cilat i nxirrnin organet krahinore, ndërsa pas avancimit të pozitës kushtetuese si njësi autonome e ish-Jugosllavisë, KSA e Kosovës kishte autorizime kushtetuese dhe legjislative, me të cilat në mënyrë të mëvetësishme i rregullonte marrëdhëniet e ndryshme shoqërore-politike, për sa e lejonte federalizmi jugosllav, duke nxjerrë Kushtetutën dhe të gjitha aktet e tjera të bazuara në të. (Arsim Bajrami)

LEGJISLACIONI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS (2008-2015). Tërësia e ligjeve të miratuara nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës që nga shpallja e pavarësisë. Para shpalljes së pavarësisë, legjislacioni i Kosovës kryesisht bazohet në Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme dhe procedura legjislative që ishte përcaktuar nga rrethanat politike të krijuara me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe administrimit ndërkombëtar të vendosur prej saj. Miratimi i Kushtetutës së Republikës së Kosovës krijoi bazën konstitucionale, në të cilën u mbështet infrastruktura legjislative e Republikës së Kosovës pas vitit 2008 dhe shtoi aktivitetin dhe përgjegjësinë e institucioneve shtetërore për kujdesin ndaj rregullimit ligjor të të gjitha marrëdhënieve shoqërore, duke përfshirë organizimin, funksionimin, të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e pjesëmarrësve në marrëdhëniet publike dhe private, si dhe raportet dhe fushat e interesit konkret të Republikës së Kosovës. Në planin e përgjithshëm, legjislacioni i Republikës së Kosovës i plotëson standardet ndërkombëtare qoftë sa i përket përmbajtjes dhe qasjes afirmative ndaj respektimit të lirive dhe të drejtave të njeriut, qoftë sa u përket parimeve demokratike të njohura dhe të proklamuar nga organizata dhe mekanizma ndërkombëtarë. Nga viti 2008 deri në vitin 2014, përgjatë dy legjislaturave të Kuvendit të Republikës së Kosovës, janë miratuar 425 ligje. Legjislacioni i Republikës së Kosovës krijohet, plotësohet dhe ndryshohet sipas procedurave të parapara kushtetuese dhe ligjore. (Arsim Bajrami)

LEGJISLACIONI SHKOLLOR. Tërësia e akteve ligjore dhe nënligjore, me të cilat rregullohet politika, organizimi dhe veprimtaria

e shkollave, si: ligjet, dekretligjet, rregulloret, vendimet, statutet, udhëzimet etj. Legjislacioni shkollor i kohës së re në Kosovë filloi në shek. XIX, në kohën e Perandorisë Osmane. Pasuan pushtuesit serbë, malazezë, jugosllavë, të cilët sollën edhe legjislacionin e tyre. Legjislacioni për shkollat shqipe në Kosovë filloi në vitin 1941, me dekretin “Rregullimi dhe organizimi i shërbimeve të Arsimit Fillor në tokat e aneksueme”. Pas Luftës së Dytë Botërore, ky legjislacion në Kosovë kaloi nëpër disa periudha: Periudha e parë përfshin vitet 1945-1957, që është periudhë e sistemit centralist-decentralist jugosllav, kur u miratuan edhe një varg ligjesh e aktesh nënligjore, si: “Ligji mbi shkollimin e obligueshëm fillor shtatëvjeçar” (1945), “Ligji mbi shkollat popullore” (1950), “Ligji mbi qeverisjen në shkolla” (1955) etj. Periudha e dytë prej vitit 1958-1968, filloi me “Ligjin e përgjithshëm mbi shkollat” (1958), i cili përligji programin e reformës së arsimit në Jugosllavi dhe u shoqërua edhe me ligje dhe akte të tjera nënligjore. Periudha e tretë prej vitit 1969-1980, fillon me “Ligjin kushtetues” të Kosovës (1969), me të cilin Kuvendi i Kosovës, ndër të tjera, fiton të drejtën për të miratuar edhe ligje. Kjo kulmoi me Kushtetutën e Kosovës (1974). Midis ligjeve dhe akteve të tjera nënligjore, të miratuara në Kosovë ishin: “Ligji mbi edukimin dhe arsimin parashkollor” (1972), “Ligji mbi përsosjen e përhershme të personelit mësimor-edukativ” (1974), “Bazat unike të arsimit dhe të edukimit fillor në Krahinën Socialiste Autonome të Kosovës” (1975) etj. Periudha e katërt prej vitit 1981-1989, që është periudhë e destabilizimit të arsimit në Kosovë, kur u miratuan disa dokumente jugosllave me pasoja të rënda edhe për arsimin shqip në Kosovë, siç janë: “Platforma politike për Kosovën” (1982), pastaj konkluzionet e dy kryesive të Jugosllavisë (1986), “Programi jugosllav për Kosovën” (1987) etj. Periudha e pestë përfshin vitet 1990-1999, e cila fillon me ligjet diskriminuese të Serbisë për Kosovën, si: “Ligji unik i arsimit fillor” (1990) dhe me vendime e masa të tjera për vendosjen e arsimit në Kosovën nën legjislacionin serb. Ndërkohë, Qeveria e Republikës së Kosovës nxori “Dekretligjin për drejtimin e përkohshëm të veprimtarisë edukativo-arsimore në Republikën e Kosovës” (1994) dhe “Dekretligjin mbi shkollimin e lartë” (1994). U nxorën edhe akte të tjera nënligjore, me të cilat u krijua baza juridike e sistemit të

arsimit në Republikën e Kosovës. Periudhën e fundit e përfshijnë vitet 2000 dhe në vazhdim, që është periudhë e reformimit rrënjësor dhe e konsolidimit të arsimit në Kosovën e pavarur. Ndër të tjera, u hartua dhe u paraqit për diskutim “Korniza e Kurikulës së re të Kosovës” (2001), u miratua “Ligji mbi arsimin fillor dhe të mesëm të Kosovës” (2002), “Ligji mbi arsimin e lartë në Kosovë” (2002), për të arritur të “Ligji për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës”, “Ligji për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës” (2011), të shoqëruar edhe me akte të tjera ligjore dhe nënligjore. (Hajrullah Koliqi)

LEJN Roz Vilder (Rose Wilder Lane) (1886-1968). Gazetare, shkrimtare. Lindi në De Smet, Dakota Jugore, SHBA. Ishte shkrimtare e prozës dhe e editorialeve, si dhe themeluese



ROZ VILDER LEJN

në Shqipërinë e asaj kohe. Ka publikuar shumë artikuj dhe tregime, ndërsa është bërë e njohur me shkrimet mbi jetën e Henri Fordit, Çarli Çaplinit dhe Xhek Londonit. Ishte biografia e parë e Herbert Huverit, presidentit të 31-të të SHBA-së. Lane njihet si një nga themelueset e Lëvizjes Libertariane Amerikane, e ndërtuar mbi parimet e promovimit të lirive individuale dhe qeverisë së minimizuar. Në vitin 1921 udhëtoi nga Franca për në Shqipëri, me ç'rast vizitoi luginën e Shalës në Shqipërinë Veriore. Qëllimi i saj ishte krijimi i një rrjeti shkollash në këtë rajon. Dy vjet më vonë ajo u kthye në Tiranë, prej nga vazhdoi të shkruante për konfliktet politike në Shqipërinë e asaj kohe. Atje adaptoi një djalë shqiptar, Rexhë Metën dhe më vonë sponsorizoi shkollimin e tij në Universitetin e Kembrixhit. Përpjekja e saj për ta sjellë atë me familje në Amerikë, pas Luftës së Dytë Botërore, dështoi. Ajo vazhdoi të shkruante deri në moshë të shtyrë. (Nita Luci)

LEKAJ Kristë (1935-). Mësimdhënës i muzikës, kompozitor. Rrjedh prej një familjeje

nga Karashëngjergji i Prizrenit, e shpërngulur në Shkup, sërish u kthye në Prizren, ku kreu edhe shkollën e mesme të muzikës. I takon brezit që studiuuan dhe u diplomuan në Akademinë e Muzikës në Beograd, në degën teorike-pedagogjike, të cilën e kreu më 1958. Në Prizren u punësua si mësimdhënës i lëndëve teorike muzikore, më pas kaloi si redaktor muzikor në Radiotelevizionin e Prishtinës dhe mësimdhënës i lëndëve veglat muzikore dhe format muzikore në Shkollën e Lartë Pedagogjike të Prishtinës. E ka zgjeruar aktivitetin muzikor edhe si kompozitor me përpunime/kompozime për zë e piano ose orkestër, vepra korale (Suita “Trualli betohet”), vokalo-instrumentale (“Arbëreshës”, kushtuar Nënë Terezës, Requiem për solistë, kor e orkestër etj), si dhe orkestrale (Poemë simfonike, Impresione folklorike I e II), aranzhues/orkestrues këngësh të muzikës së lehtë e argëtuese dhe dirigjent formacionesh orkestrale. (Zeqirja Ballata)

LEOTI Anxhelo (Angelo Leotti) (1884-1963). Gjuhëtar, albanolog italian. Edhe pse u doktorua në jurisprudencë, u mor me linguistikë. Miqësia me Zef Skiroin, të cilin e pati edhe mësimdhënës në Institutin Oriental të Napolit, i ushqeu interesimin për letrat shqipe. Dy veprat e tij të rëndësishme janë “Gramatikë elementare e gjuhës shqipe (dialekti toskë)” e vitit 1915 dhe “Shqipja e folur: shënime gramatikore: fjalor shqip-italisht dhe italisht-shqip (dialekti gegë)” e vitit 1916. Dha mësim të shqipes në Universitetin e Firencës. Kryevepra e tij është “Fjalor shqip-italisht” (Dizionario albanese-italiano, 1937), me parathënie të N. Joklit. Fjalori përmban 30 mijë zëra me 2,500 proverba e idioma. (Shpëtim Elezi)

LEPAJA Lutfi (1945-). Shkrimtar. Lindi në fshatin Bajçinë të Podujevës. Kreu shkollimin fillor në vendlindje, ndërsa të mesmin në Mitrovicë. Bashkëpunoi për një kohë me televizionin “Rrokum” dhe të përjavshmen “Java”, në të cilën publikoi shkrime të ndryshme. Shkruan prozë, poezi, dramë dhe polemikë dhe njihet si njëri nga krijuesit më të veçantë të gjeneratës së tij. Botoi përmbledhjen e poezive për fëmijë “Valëza e lumit” (1977), romanet: “Tepër serioz” (1978), “Parimi i pritjes” (1982), “Përqaftimi i padukshëm” (1984), “Gëte ka të drejtë” (1985), “Ofertë për pendim (2010), pastaj librat me tregime dhe novela “Kona”

(1979) dhe “Shkollë për specialistë” (2000), si dhe librin me ese “Ngutja në jetë” (2000) dhe përmbledhjen me poezi “Granas lament” (2002). Ka botuar një mori krijimesh artistike e shkrimesh eseistike në gazeta e revista letrare dhe është fitues i disa çmimeve letrare në konkurse të ndryshme. Radio-Prishtina realizoi tri radiodrama të tij dhe vuri në skenë monodrama “Ruleti kosovar”, me të cilën mori pjesë në Festivalin e Monodramës në Korçë në vitin 2010. (Adil Olluri)

LEPAJA Salem (1955-). Inxhinier i elektroteknikës, mësimdhënës universitar. Lindi në Prishtinë. Shkollimin bazë dhe Fakultetin Elektroteknik i kreu në Universitetin e Prishtinës (UP) (1978). Studimet pasuniversitare në fushën e telekomunikacionit i kreu në Fakultetin Elektroteknik të Universitetit të Zagrebit, ndërsa disertacionin e mbrojti në Universitetin Teknik të Vjenës (2005) në lëmin e rrjeteve komunikuese mobile. Në fillim punoi në PTT në Prishtinë dhe më pas ligjërues në Fakultetin Elektroteknik të UP-së (1979-2000). Në periudhën 2000-2003 ishte bashkëpunëtor shkencor në Institutin për Rrjete Komunikuese në Universitetin Teknik të Vjenës. Mori pjesë në shumë konferenca shkencore ndërkombëtare. Është bashkautor i librave universitarë: “Përmbledhje detyrash të zgjidhura nga teoria e qarqeve elektrike” (1985) dhe “Kompjuterika dhe komunikimet” (1998) si dhe i tekstit për shkollat e mesme “Bazat e elektroteknikës I” (1988). Si autor ose bashkautor publikoi një sërë punimesh shkencore dhe profesionale në fushën e rrjeteve komunikuese. Gjatë viteve 1991-2000 kreu detyra të ndryshme në UP dhe në FE. Është ligjërues në departamentin e teknologjisë së informacionit dhe të kompjuteristikës në kolegjin gjerman në Rijad të Arabisë Saudite. (Nebi Caka).

LEPENCI. Lumë në pjesën jugore të Fushës së Kosovës, që formohet nga rrjedhat ujore, të cilat burojnë nga pjesa veriore e Maleve të Sharrit. Sipërfaqja e pellgut ujëmbledhës është 738 km², ndërsa në territorin e Kosovës gjenden 678,6 km², kurse pjesa tjetër në Maqedoni. Pjesa e epërme e pellgut përbëhet nga rreshtet e paleozoit, serpentinitet dhe sedimentet glaciale. Pjesa e poshtme është e thelluar në rreshtet e palozoit dhe flish. Gjatësia në territorin e Kosovës është 65 km. Në pjesën e sipërme të



PAMJE NGA RRJEDHA E LEPENCIT

pellgut, Lepenci formohet nga dy rrjedha ujore, njëra prej tyre vjen nga shpatat veriore të Maleve të Sharrit, ndërsa dega tjetër nga malet Oshlak, Koxhaballkan, Zhar dhe Jezerc. Është lumë alpin, që karakterizohet me luginë të pjerrët, gryka të ngushta dhe fuqi të madhe erozive. Gjatë rrjedhjes nëpër Malet e Sharrit, Lepenci kalon nëpër trevën e Siriniqit, del në Fushën e Kosovës dhe rrjedhën e tij e kthen në drejtim të jugut, kur futet në grykën e Kaçanikut (24 km), grykë e kushtëzuar nga kontakti litologjikotektonik. Reshjet mesatare vjetore në pellgun e Lepencit janë 893 mm, që është mbi mesataren e reshjeve në Kosovë. Prurja mesatare vjetore e Lepencit është 9.1 m³/sek. Prurjet maksimale janë në muajin maj (14.6 m³/sek), ndërsa minimalet në muajin shtator (3.1 m³/sek). Karakterizohet me regjim nivalo-pluvial (borëshi), me prurjet më të madhe gjatë pranverës, që kushtëzohen nga shkrirja e borës në zonat e larta malore të Sharrit. Për dallim nga lumenjtë e tjerë të pjesës lindore të Kosovës, Lepenci dallohet për koeficientin e lartë të rrjedhjes totale (0.52), që vjen si pasojë e morfologjisë së relievit, kushteve klimatike, ndërtimit gjeologjik etj. Në Kaçanik i bashkohet dega kryesore e tij, Nerodimja. Në afërsi të Shkupit, Lepenci derdhet në lumin Vardar. (Valbon Bytyçi)

LEPOSAVIQI. Qytezë në veri të Kosovës. Shtrihet në luginën e Ibrit, ndërmjet shpateve të Rogoznës në anën e majtë dhe të Kopaonikut, në anën e djathtë. Si vendbanim përmendet në disa dokumente të shkruara. Sipas regjistrimit të vitit 1913 kishte 84 banorë, në vitin 1921 kishte 90 banorë. Në vitin 1981 qyteza kishte 1,191 banorë, ndërsa sipas të dhënave të regjistrimit të vitit 1991 (vlerësim), kishte 2,999 banorë, nga të cilët shumica dërrmuese ishin



LEPOSAVIQI

serbë. Leposaviqi ka pozitë të mirë gjeografike, meqenëse nëpër të kalon magjistralja e Ibrit dhe hekurudha që bën të mundur lidhjen me Mitrovicën dhe Prishtinën, në jug, dhe brendësinë e Serbisë, në veri. Vendet përreth Leposaviqit janë të pasura me xehe të hekurit, të plumbit dhe të zinkut. Për këtë arsye në Leposaviq është ndërtuar flotacioni i plumbit dhe zinkut, në kuadër të kombinatit të Trepçës. Punësimi i banorëve në këtë sektor të industrisë e shndërroi Leposaviqin në një vendbanim agraro-industrial. Ishte qendër komunale dhe në të ishin të vendosur disa institucione me rëndësi për popullsinë e komunës. Nga objektet e standardit shoqëror, Leposaviqi ka shkollën fillore tetëvjeçare dhe shkollën e mesme teknike, ndërsa institucionet shëndetësore janë të integruar me qendrën mjekësore në Mitrovicë. Popullsia merret me tregti, hoteleri, turizëm dhe zeytari. (Nazif Gashi)

LEPOSAVIQI (komuna). Komunë në veri të Kosovës, shtrihet nga shpatet lindore të malit Rogozna, në perëndim, deri te shpatet juglindore të Kopaonikut, në lindje. Sipërfaqja e territorit të komunës së Leposaviqit është 539 km², me 47 zona kadastrale. Nga ana veriore kufizohet me Serbinë, në lindje me komunën e Podujevës, në jug me komunën e Zveçanit, kurse nga jugu dhe juglindja me komunën e Mitrovicës. Pozitën e mirë komunikuese ia mundëson magjistralja automobilistike dhe hekurudhore, e cila lidh Kosovën me Serbinë dhe më tej me brendësinë e Gadishullit Ballkanik. Dominon relievi kodrinor-malor (rreth 90%). Rrjetin hidrografik e përbën lumi Ibër me degët e tij. Klima është e mesme kontinentale, ndërsa në viset malore edhe klima submalore. Komuna e Leposaviqit ka

75 fshatra, prej të cilave tri janë me popullsi shumicë shqiptare. Në vitin 1981 komuna kishte 16,906 banorë, ndaj 14,851 banorëve sa kishte në vitin 1948. Në komunën e Leposaviqit, sikundër edhe në komunat e tjera me shumicë serbe në veriun e Kosovës, nuk u bë regjistrimi i fundit i popullsisë. Sipas regjistrimit të vitit 1991 dhe vlerësimeve, në territorin e kësaj komune jetonin 16,291 banorë. (Nazif Gashi)

LERANI. Vendbanim rural në komunën e Preshevës. Shtrihet në shpatet perëndimore të malit të Rujanit, përgjatë rrugës Vranjë-Kumanovë, në lartësi mbidetare 450 m. Në luginën e lumit të Leranit ndodhet një burim termal, i njohur si “ujë shërues”. Sipërfaqja e territorit të fshatit është 900 ha. Derisa në vitin 1961 fshati kishte 668 banorë, në vitin 2002 u regjistruan 945 banorë. Shqiptarët me afro 80% (2002) përbëjnë pjesën dërrmuese të popullsisë së fshatit, ndërsa të tjerët janë serbë. Nga objektet e standardit shoqëror, fshati ka shkollën fillore, stacionin shëndetësor dhe disa njësi të tjera shërbyese. Është seli e bashkësisë lokale për dhjetë vendbanime përreth. (Arsim Ejupi)

LESHAKU. Fshat në komunën e Leposaviqit, 9 km në verilindje nga qendra. Shtrihet në anën e djathtë të luginës së lumit Ibër. Sipas regjistrimit të vitit 1991 (vlerësim) kishte 1,821 banorë, ndaj 578 banorëve, sa kishte në vitin 1948. Nëpër Leshak kalon magjistralja e Ibrit, që lidh Kosovën me Serbinë. Paralel me rrugën automobilistike kalon edhe hekurudha. Këto linja të komunikacionit i japin këtij vendbanimi atributet e një nyje të rëndësishme të komunikacionit. Popullsia merret me bujqësi dhe blegtori, ndërsa një pjesë e popullsisë është e inkuadruar në sektorin sekondar dhe terciar. Si vendbanim përmendet në disa dokumente të shkruara mesjetare të vitit 1395 me emrin Ljeslik. Haset edhe në shënimet e një harte austriake të vitit 1689. Sipas regjistrimit të vitit 1913, Leshaku kishte 166 banorë, kurse në vitin 1953 kishte 112 shtëpi me gjithsej 690 banorë. Në strukturën etnike dominojnë serbët. Nga objektet e standardit shoqëror ka shkollën tetëvjeçare, stacionin shëndetësor, shtëpinë e kulturës me bibliotekë, disa objekte tregtare etj. (Nazif Gashi)

LESHANI. Fshat në komunën e Pejës, 12 km në juglindje të saj. Shtrihet në lartësi mbidetare 400 m. Sipërfaqja e territorit të fshatit është 539 ha, nga e cila pjesën dërrmuese (90%) e zënë arat. Është vendbanim i tipit të shpërndarë me lagjet Lugaxhi, Leshan dhe Zabel. Përmendet si vendbanim në regjistrin kadastral të sanxhakut të Shkodrës (1485). Në hartën austriake të vitit 1689 është regjistruar me emrin Lishtan. Gjatë periudhës së Mbretërisë Jugosllave këtu vendosen 36 familje serbo-malazeze. Në vitin 2011 Leshani kishte 354 banorë, ndaj 552 banorëve në vitin 1948. Popullsia merret kryesisht me bujqësi, blegtori, tregti etj. Nga objektet e standardit shoqëror ka shkollën 9-vjeçare, stacionin shëndetësor etj. (Ferim Gashi)

LETËRKREDIA. Instrument financiar i emtuar nga një bankë, e cila garanton se pagesa e një blerësi ndaj shitësit do të bëhet në kohë dhe në shumën e caktuar. Në rast se blerësi nuk është në gjendje ta bëjë pagesën për blerjen, banka do të jetë e obliguar ta mbulojë shumën e plotë ose pjesën e mbetur të pagesës. Letërkreditë shpeshherë përdoren në transaksionet ndërkombëtare, për të siguruar se pagesa do të realizohet në rastet kur blerësi dhe shitësi nuk mund të njohin njëri-tjetrin dhe janë duke operuar në vende të ndryshme. Në këtë rast shitësi është i ekspozuar ndaj një numri të rreziqeve, siç është rreziku kreditor dhe rreziku ligjor. Për këtë arsye përdorimi i letrave të kredisë është bërë një aspekt shumë i rëndësishëm i tregtisë ndërkombëtare. Letërkredia në Kosovë është një instrument financiar me rëndësi, i përdorur dhe i ofruar nga bankat e Kosovës, duke marrë parasysh vëllimin e importeve në ekonominë e Kosovës. (Valentin Toçi)

LETËRSIA BASHKËKOHORE (KOSOVË). Letërsia e nisur si adhurim për kulturë, e zhvilluar si vlerë estetike. Esad Mekuli (1916-1993) me librin “Për ty” (1955) shfaq kredon letrare e humane. Poezitë themelore të tij kanë rebelimin poetik-social të viteve ’30, si vjersha të kohës së robnimit. Nga këndimi elegjiak autori kalon në këndimin thirrësor për kohën e re, që më vonë do të marrë formë të dëshpërimit. Martin Camaj (1925-1992) në Kosovë botoi librat “Nji fyell ndër male” (1953) dhe “Kanga e vërrinit” (1954), në të cilët thuri mallin e shprehjen dukagjinase me figurat kryesore të këngëtimit:

fyell e kangë në mal e në vërri. Hivzi Sulejmani (1910-1975), autor që lidh vrullin revolucionar me dilemat e njeriut. Kjo u bë thelb i letërsisë autobiografike të romani “Njerëzit” (1961) dhe të tregimet “Era dhe kolona” (1960). Heroi i tij i rebeluar social e ideologjik bëhet i rebeluar në përmasën humane. Enver Gjerqeku (1928-2008) në fillim e në fund paraqitet si lirik intim edhe kur shqipton reflektime nacionale. Forma e tij e preferuar është vargu klasik në formën e tingëllimës. Këto duken edhe në librat “Blerimi i vonuem” (1966) dhe “Xixa stralli” (1976). Ramiz Kelmendi (1930-1997) shkruan prozë me një theks ambiental në ligjërim e në karakterizim. Kjo kurorëzohet në veprat “Ahmet Koshutani” (1972) e “Shtatë persona ndjekin autorin” (1975). Tematika e tij letrare sprovohet me raportin e individit me pushtetin. Adem Demaçi (1936), kurorë e veprës së tij rinore është romani “Gjarpijt e gjakut” (1958), i shkruar me një idiomatikë shqipe vendëse dhe me tematikë nacionale. Ky rebelim letrar individual u përkthye në rebelim shoqëror për çka përdhunshëm u ndërpre talenti i tij krijues me burgimin e gjatë. Din Mehmeti (1932-2010) në librin e parë “Në krahët e shkrepave” (1961) krijon poezinë dëftore me figurë ambientale si mjet identifikimi. Më vonë gjuha e tij poetike dhe meditimi shkojnë kah rritjet e dilemave, ku vjersha reduktohet në formë. Një titull shenjues “As në tokë as në qiell” (1988). Fahredin Gunga (1936-1997) me librin “Pëshpëritjet e mëngjesit” (1961) shenjoi talentin. Libri i tij më në shenjë “Psalmet e gurta” (1977) ku arrin një harmoni të formës, të mendimit e të porosisë. Poezi e psalmeve. Azem Shkreli (1938-1997), poet e prozator. Karakteri i tij letrar del te “Bulëzat” (1960), “Karvani i bardhë” (1961) e “Sytë e Evës” (1965). Gjuha e tij merr formën e disiplinës së mendimit si urti e fjalës. Ali Podrimja (1942-2012), poet i rebeluar: nga kanga e shpallur te dhembja e bukur, nga shprehja dëftore te sinkopa, për të shkëlqyer me kryqëzimin e temave e dilemave te “Lum Lumi” (1982). Rahman Dedaj (1939-2005), poet lirik, si ndjesi dhe si figurë, te “Me sy kange” (1962), vijuar me “Simfonia e fjalës (1968), e “Balada e fshehur” (1970). Metafora në funksion të komunikimit intim. Nazmi Rrahmani (1940) u bë i njohur me romanin ambiental “Malsorja” (1965), me heroinën morale, Hajrijen. Temat sociale, shpërngulja, idioma gjuhësore,

ndërtimi dramatik shquajnë romanet e tij. Anton Pashku (1937-1995), prijatari i letërsisë moderne në Kosovë. Kryevepra e tij, romani "Oh" (1971) me strukturim të prozës moderne, sublimon teknikat novelistike dhe tematikat shqiptare në antikë e në bashkëkohësi. Një ligjërimit letrar i antiutopisë shqiptare. Gjuha e tij në prozë është metaforike, madje me ritmikë poezie. Dramat e tij ("Gof" e "Sinkopa") artikulojnë pësimin e jo veprimin dhe kanë teksturë si të prozës. Rexhep Qosja (1936) e fillon krijimtarinë si kritik letrar dhe e vijon me prozë dhe dramë. Janë në shenjë studimet historike-letrare. Romani "Vdekja më vjen prej syve të tillë" (1974) ka në thelb raportin e vështirë ndërmjet individit dhe pushtetit agresiv. Qosja në drama synon transkriptimin e mitit në zhvillim dramatik. Beqir Musliu (1945-1996), poet, prozator e dramatisht. Temat e tij letrare lakohen në të tri forma. Është dashurues i shprehjes moderne poetike nga "Rima të shqetësuese" (1965) te "Bukuria e zezë" (1968). Musa Ramadani (1944) poet e prozator, në librin "Mëkatet e Adamit" (1969) artikulon shenja të avangardizmit. Ky kërkim duket te romani epik "Ligatina" (1983) e te antiromani "Antiprocesioni" (1997). Teki Dërvishi (1943-2011), poet, prozator e dramatisht. Shpirti lirik është karakteristikë e letërsisë së tij edhe në prozë edhe në dramë: "Pirgu i lartë" (1972) e "Bregu i pikëllimit" (1985). Një subjektivizim i hollë i dramatikës nacionale. Eqrem Basha (1948) poet, prozator e përkthyes letrar. Në poezi fut zhargonin e përditshëm, "Opuset e maestros" (1971). Në këtë kërkim mbindërtohet ironia e hollë për *odën e mesit*. Litota e Bashës zhvillohet edhe në prozë: "Shëtitje nëpër mjegull" (1971) e "Marshi i kërmillit" (1994). Sabri Hamiti (1950), poet, romansier, dramatisht, kritik. Nga libri i parë "Njeriu vdes i ri" (1972) te i mbrami "Sympathia" (2004), formon një sistem poetik e një botëkuptim, që plotësohet me prozë e dramë. Me librat kritikë, nga "Variante" (1974) te "Utopia letrare" (2013), provon të ligjësojë poetikën shqipe. Zejnullah Rrahmani (1952) tregimtar dhe romancier, bën variacione me tema shqiptare. Në romanet e tij "Sheshi i unazës" (1978) e "Romani për Kosovën" (2000) kjo realizohet me varietete ligjërimesh mimetike apo të figuruar që shkojnë nga proza e poetizuar, kah kombinimet e mbindërtimet ditunore. Mehmet Kraja (1952) tregimtar,

romancier, dramatisht, krijon pamjen e ambientit dhe fiksionin letrar të historisë nacionale. Një portretim në variante i shpirtit kolektiv që sprovohet nëpër ngushtica të ekzistencës. Të shënjuar romanet "Udhëzime për kapërcimin e detit" (1984) e "Edhe të çmendurit fluturojnë" (2004). Autorë të njohur janë edhe Zekeria Rexha, Besim Bokshi, Nexhat Halimi, Ymer Shkreli, Jusuf Buxhovi, Ibrahim Kadriu, Agim Vinca, Mirko Gashi, Arif Demolli, Edi Shukriu, Shaip Beqiri, Abdullah Konushevci, Ramadan Musliu, Adem Gashi, Milazim Krasniqi, Basri Çapriqi, Ibrahim Berisha, Sali Bashota. (Sabri Hamiti)

LETËRSIA BASHKËKOHORE (SHQIPËRI).

Letërsia shqipe e gjysmës së dytë të shek. XX. Kanonizim letrar në trajtën e realizmit socialist mbi bazë ideologjike. Gjallërim i modernizmit, si alternativë letrare. Disidencë politike si disidencë letrare. Mohimi e mënjanimi i autoriteteve letrare të periudhës pararendëse. Autorët e rinj të periudhës pararendëse konvertohen në metodën letrare: Sterjo Spasse (1912-1989) me romanin "Afërdita përsëri në fshat" (1955); Dhimitër Shuteriqi (1915-2003) me romanin "Çlirimtarët I, II" (1952-1955) e bëhet artikules i metodës; Petro Marko (1913-1991) me romanin "Hasta la vista" (1958) e vijon me rebelimin. Luftë (çlirimtare), utopi, internacionalizëm; nënvizime të forta të ideologjisë komuniste të absolutit të përparimit. Kjo frymë zotëron letërsinë në dy dekadat e para. Ismail Kadare (1936) është shkrimtari më i famshëm shqiptar, edhe botërisht, i letërsisë bashkëkohore. Me romanin "Gjenerali i ushtrisë së vdekur" (1963), që u kurorëzua brenda e jashtë si kryevepër e tij letrare, krijoi përmbysje të habitshme duke e parë të mposhtur dhunën luftarake të pushtuesit. Me romanin "Kronikë në gur" (1971) shkroi kronikën e parakalimit të pushtuesve në qytetin e lindjes duke e përthyer nëpër fantazitë e fantazmagoritë e djaloshtit shqiptar. Me romanin "Pallati i ëndrrave" (1981) krijoi parabolën e shoqërisë totalitare, shtypjen e individit, antiutopinë e komunizmit. Kadare shkroi të tjera romane të mbështetura në referenca reale-historike, në tema e mite kombëtare apo të perceptimeve personale e autobiografike. Në veprat e përmendura u krijua stili i tij i mbështetur në paradoks, në shpërthime lirike e në shtresime alegorike, duke krijuar një letërsi origjinale. Shkroi poezi

e ese, "Ftesë në studio" (1990), pa arritur ta rivalizojë Kadarenë romancier. Shkrimtar i propozuar për Nobel. Jakov Xoxa (1923-1979) novelist e romancier projektton romanin e gjerë epik, duke synuar romanin e munguar realist në letërsinë shqipe, duke rrokur periudha të jetës së vendit. Për idetë, strukturën e stilin e tij vepra kryesore mbetet romani "Lumi i vdekur" (1965), përpara romaneve "Juga e bardhë" e "Lulja e kripës". Dritëro Agolli (1931) është poet e prozator. Shkroi lirika të përmallshme me shprehje e rima spontane, romane me mjeshtëri të ndërtimit të karaktereve: "Komesari Memo" (1970), "Njeriu me top" (1975). Vepra e tij kryesore është "Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zyllo" (1973), në të cilin refuzohet kalueshëm një gjendje shoqërore duke portretuar tragjikomedinë e njeriut vartës. Një stil ku thuret humori, ironia e satira si vlera letrare. Bilal Xhaferri (1935-1986) gatiti librat: "Njerëz të rinj, tokë e lashtë" (1966), "Lirishta e kuqe" (1967) e "Krastakraus" (1968). Autori i ndaluar emigroi në Amerikë. Xhaferri hartoi vepra me rrishtën e jetës personale, të ambientit, të historisë kombëtare, me një gjuhë të figuruar. Veçohen vjershat për Çamërinë. Vepra e tij kryesore është romani "Krastakraus". Kasëm Trebeshina (1926) ka statusin ndërmjet disidentit politik (në ide) e shkrimtarit disident (në metodë). "Promemoria", që i atribuohet t'ia ketë dërguar diktatorit Hoxha më 1953, duke gjykuar sistemin politik e sistemin letrar, duket që përcaktoi fatin e tij letrar. Dëshmohej që ka dhjetëra dorëshkrime; por pak nga kjo është botuar. Një stil i prozës së poetizuar shfaqet te veprat: "Stina e stinëve" (1991) e "Kënga shqiptare" (2001). Është autor ende i pabotuar e i pavlerësuar. Veçohen edhe prozatorët: Sabri Godo (1929-2011), Naum Prifti (1932), Dhimitër Xhuvani (1934-2009), Vath Koreshi (1936-2006), Zija Çela (1946). Nga poetët e etabluar në vitet '60, Fatos Arapi (1930) shkëlqimin e kërkoi me ngulm në poezi, duke e disiplinuar shprehjen perifrastike, kah figura e prerë me një lirizëm të motivuar, që shpërthen herë në imazhe e herë përkufizohet në meditime në një varg veprash "Shtigje poetike" (1962), "Poema e vjersha" (1966), "Më jepni një emër" (1971). Xhevahir Spahiu (1945) është poet që këndon me patos të lartë vjershën thirrërore dhe kur formën e saj e redukton në trajtë të artisë poetike. Ia ka ëndja shprehjen e prerë, duke e dashuruar gjuhën në veprim. Këto

karakteristika lexohen në formulimet e titujve: "Mëngjes sirenash" (1970), "Vdekje përëndive" (1977), "Heshtje s'ka" (1989). Frederik Rreshpja (1940-2006) bashkon në shprehje e në frymë poezinë dukagjinase, të cilën nga reminishenca epike e përkthen në lirizëm metaforik personal në kufi të vetmisë e të melankolisë. "Rapsodi shqiptare" (1968), "Erdhi ora të vdes përsëri" (1994). Një botë e vetmuar që kërkon mbijetesën në burgime të gjata. Dallohen edhe poetët e poeteshat: Natasha Lako (1948), Bardhyl Londo (1948), Moikom Zeqo (1949), Preç Zogaj (1957), Besnik Mustafaj (1958), Visar Zhiti (1952), Luljeta Lleshanaku (1968). Rast i veçantë tragjik është poeti i rebeluar Havzi Nela, i varur nga pushteti. Disident në metodë krijuese është Zef Zorba (1920-1993), me librin poetik "Buzë të ngrira në gaz", (1994). Një strukturë bodleriane, unike si formë paraqet alternativën e poezisë bashkëkohore në Shqipëri. Në vitin '90 kur ra sistemi komunist e u shpërbë dogma socrealiste, nisi një decenie e ndërkomunikimeve kaotike, në trajtë dialogësh e monologësh: rikthehen autorët e ndaluar, nisin rivlerësimet e shfaqen autorë të rinj. Letërsia nisi të shkruhet si pasojë e diktaturës. Dallohen atë Zef Pllumi (1924-2007) me prozën dokumentare "Rrno vetëm për me tregue" (1995-2001); Fatos Kongoli (1944) me romanin "Kufoma" (1994), Agron Tufa (1967) me romanin "Dueli" (1998), i shquar si talenti i parë i literaturës mbas socrealiste. (Sabri Hamiti)

LETËRSIA E BEJTEXHINJVE. Krijimtaria letrare shqipe e shkruar me alfabet arab dhe nën ndikimin e poetikës dhe estetikës klasike orientale-islame. Kah fundi i shek. XVII filloi ngecja e letërsisë në gjuhët orientale (arabe, perse dhe turke), e krijuar edhe nga krijuesit shqiptarë dhe kjo, njëherësh shënon fillimin e krijimtarisë letrare në gjuhën shqipe, të shkruar me alfabet arab, që përfshin periudhën nga fillimi i shek. XVII deri në gjysmën e parë të shekullit XX. Kjo letërsi ishte shkruar në bejte (dyvargësh) dhe në qarqet shkencore ndërkombëtare njihet si letërsi alhamiada (nga fjala arabe *al-axhamia* që domethënë: e huaj, jo arabe) e shkruar me alfabet arab në gjuhët e popujve të ndryshëm: spanjoll, boshnjak, shqiptar, grek, ukrainas etj. Krijimtaria artistike e alhamiados ndahet në dy grupe kryesore: sufiste dhe laike. Rryma sufiste është më e pranishme, më e pasur dhe mbështetet në

elementet e teozofisë islame-tesavufit. Shumë krijues u përkisnin radhëve të ndryshme dërvishë, krijimtaria e të cilëve me poetikën e vet i përgjigjet parimeve të njohjes së Zotit, ndërsa poezia laike përbëhet nga tematika shoqërore e fetare, që flet për religjionin me dozën e fuqishme të didaktizmit. Me interes dhe vlerë të veçantë janë ato tekste shqipe të alhamiados, të cilët flasin për rrethanat shoqërore-politike në trojet shqiptare gjatë periudhës osmane, duke kritikuar degradimin e sistemit të drejtësisë dhe atij moral. Kjo rrymë pati jehonë në krijimtarinë poetike të Nezim Frakullës, Sulejman Naibit, Hasan Zyko Kamberit, Zenel Bastarit etj., të cilët përbëjnë fazën e parë të krijuesve bejtexhinj. Në veprat e këtyre poetëve, krahas frymës fetare-filozofike gjeti shprehje edhe fryma laike, kurse në veprat e fazës së dytë, që nis nga gjysma e shekullit XIX dhe vazhdon edhe gjatë shekullit XX, mbizotëroi tema me karakter fetar, ku krahas poezisë krijohen dhe vepra didaktike fetare si: mevlude, manuale shkollore, deri tek ato morale-didaktike, fjalorë turqisht-shqip etj. Kështu, në shek. XVIII vepruan poetët e parë bejtexhinj, të cilët bënë provat e para të poezisë shqipe me vlera artistike, sado që me përmbajtje të përzier fetare e laike, por mjaft të pasur e të motivuar. Këta krijues e pasuruan letërsinë shqipe me tema të reja, me gjini letrare, si poema (mesnevi), ilahi (kënga fetare), deri te lirika (gazeli), panegjerika, elegjia, satira etj. Me këto risi që sollën bejtexhinjtë, konsiderohet se nisi të zhvillohej letërsia artistike shqipe, e cila dilte nga rrethi i ngushtë i letërsisë fetare e didaktike dhe filloi të ngrihej në nivel të një letërsie artistike. Prandaj, kjo krijimtari letrare i dha dimension të ri letërsisë dhe kulturës shqiptare. Kjo krijimtari poetike e karakterizoi shek. XVIII, periudhën para lindjes së letërsisë kombëtare të Rilindjes Shqiptare. (Abdullah Hamiti)

LETËRSIA E DIVANIT ME AUTORË SHQIPTARË. Letërsi në gjuhët orientale, e krijuar nga fundi i shek. XV deri në shek. XX. Lindi dhe u zhvillua në kuadër të letërsisë osmane të divanit, si prodhim letrar i popujve që përbënin Perandorinë Osmane. Divani është përmbledhje poezish, të krijuara sipas rregullave të caktuara. Llojet poetike të lëvruara më shumë nga autorët shqiptarë të divanit janë: gazeli, kasideja, mesnevija, rubajja, mystezati,

musemmati, ilahija, nefesi, nati, tarihi etj. Autorë shqiptarë që e krijuan divanin ishin të shkolluar në qendra të njohura arsimore osmane, ku patën mundësi të zotërojnë osmanishten, arabishten dhe persishten dhe të njohin traditën letrare të popujve të Orientit, në veçanti klasicizmin persian. Disa prej tyre madje arritën të bëhen ndër poetët më të mëdhenj e më të famshëm në Perandorinë Osmane. Për këta poetë ndonjëherë është thënë se arritën të futnin një frymë europiane në letërsinë osmane.

Përfaqësuesit më të njohur shqiptarë të letërsisë së divanit nga Kosova janë: Jahja bej Dukagjini (1489-1578), Isa "Mesih" Prishtina (1470-1512) dhe Muhamed "Suzi" Prizreni (1456-1524). Vëllezërit e Suzit, Ramadan "Nehari" (vdiq më 1522), dhe "Sa'ji" (vdiq më 1538), gjithashtu kanë qenë poetë të shquar. Behar Prishtina (vdiq më 1531) ka lënë një vepër poetike me të cilën përshkruan pushtimin e Budimit nga Sulltan Sylejmani në vitin 1526. Vëllezërit Mustafa "Azmi" (vdiq më 1542), Husamedin "Levhi" dhe Dervish "Nuh" nga Prishtina (shek. XVI), gjithashtu kanë qenë poetë të njohur. Poetë të shquar nga Prizreni kanë qenë edhe Muhamed "Haki" Prizreni (shek. XVI), Mu'min Prizreni (shek. XVI), Nihadi Çelebi Prizreni (shek. XVI) dhe Umami Sinan Prizreni (vdiq 1551). Mustafa "Shem'i" Prizreni (vdiq 1596) ka bërë emër me komentet e veprave më të njohura të poetëve persianë, të Saadiut, të Feriduddin Attarit, të Xhelalud-din Rumiut etj. Ai në vitin 1578 ka shkruar edhe një vepër lidhur me etikën dhe misticizmin islam. Abdylkadër "Texhel-li" Prizreni (vdiq më 1688) ka lënë një divan specifik. Edhe poetët Ahmed Pashë Dukagjini (vdiq më 1514), Ahmed bej Dukagjini (vdiq më 1557), Mustafa Sani bej Dukagjini (fundi i shek. XVI), Osman bej Dukagjini (vdiq më 1603), Fasih Ahmed Dede Dukagjini (vdiq më 1699) dhe Mehmed efendi Peja (vdiq më 1601) kanë qenë të shquar. Sheh Sylejman "Axhiz" Baba ka qenë një poet i dëshmuar. Skender "Zari" Prishtina, pastaj djali i vëllait të tij, Jakup "Mejli" Prishtina (vdiq më 1824) dhe Hysejn efendi Prishtina kanë qenë poetë të shquar. Poetë të dalluar nga Gjakova kanë qenë Sejfedin "Zija" Pasha i biri i Ali Pashë Gegës (vdiq më 1790), Ahmed Kurt Pasha (vdiq më 1827) dhe Mustafa Pasha, i biri i Sejfedin Pashës, si dhe baballarët bektashinj, Adem Vexhi Baba (1841-1927) dhe Baba

Hamza (1882-1952). Mulla Rexhepi, i biri i sheh Sylejmanit nga Rahoveci, në vitin 1744 ka shkruar një përmbledhje vjershash. Edhe Dervish Sadullah "Hylkiu", i biri i sheh Nijaziut nga Rahoveci, është autor i një veprë poetike, të shkruar në vitin 1855. Abdurrahman "Fidai" efendi Prizreni (vdiq më 1855) është autor i 12 veprave. Mehmet Tahir efendi Prizreni është autor i rëndësishëm i gjysmës së dytë të shek. XIX. Edhe Haxhi Ymer Lutfi Paçarizi, sheh Selim "Sami" Drejta nga Vushtrria, sheh Hilmi Maliqi nga Rahoveci dhe sheh Mehmet "Sezai" nga Prishtina kanë lënë një trashëgimi të pasur poetike. (Nehat Krasniqi)

LETËRSIA E HUMANIZMIT. Humanistët shqiptarë janë pjesë e lëvizjes humaniste europiane që lindi së pari në Itali, lëvizje që synonte rikthimin e vlerave të antikitetit greko-romak në kulturën europiane. Humanizmi shndërrohet në një lëvizje paneuropiane, sepse kur lindi humanizmi gjuha e kulturës dhe e librit ishte latinishtja. Humanistët shqiptarë shkruajnë në latinisht, aderojnë plotësisht në vlerat e lëvizjes humaniste, por janë shqiptarë për shkak të origjinës së tyre dhe pohimit krenar të saj si dhe për shkak se në veprat e tyre trajtojnë tema dhe personazhe historike shqiptare kryesisht të Gjergj Kastriotit dhe rezistencës së tij antiosmane. Autori më i rëndësishëm i humanizmit shqiptar është Marin Barleti (1450-1512), prift shqiptar nga Shkodra i larguar në Republikën e Venedikut pas rënies së Shkodrës në dorën e turqve në vitin 1478. Dy veprat e tij më të rëndësishme janë "Rrethimi i Shkodrës" (De obsidione Scodrensi), botuar në Venedik në vitin 1504 dhe "Historia e jetës dhe bëmave të Skënderbeut, princit të Epirit" (Historia de vita et gestis Scanderbergi, Epirotum Principis), botuar në Romë në vitet 1508-1510. "Rrethimi i Shkodrës" dhe "Historia e Skënderbeut" janë të rëndësishme për kulturën shqiptare, sepse ato shërbejnë si burime informacioni për rezistencën antiosmane të shqiptarëve dhe për figurën më të rëndësishme të historisë së tyre Gjergj Kastriotin-Skënderbeun. Të dhënat historike për Skënderbeun dhe rezistencën e tij antiosmane jepen nga një autor që i ka përjetuar që në të gjallë ngjarjet ose i ka mbledhur dëshmitë nga persona që kanë qenë pjesëmarrës në to. Përmes veprës së Barletit kjo rezistencë dhe heroi kryesor i

saj Gjergj Kastrioti-Skënderbeu bëhet pjesë e dijes, kulturës dhe artit europian, siç është tashmë e dëshmuar. Humanisti tjetër shqiptar, Marin Biçikemi (1468-1526), po nga Shkodra, është autor i disa veprave, mes tyre edhe i një veprë për rrethimet e Shkodrës 1474 dhe 1478. Dhimitër Frëngu (1443-1525), me origjinë nga Drishti, mbështetur në "Historinë e Skënderbeut" të Barletit, shkroi një panegjirik, i cili u botua në Venedik në vitin 1539. Shqiptarë humanistë të shquar me kontribut në fushën e dijes dhe të kulturës qenë edhe Gjon Gazulli me origjinë nga Mirdita, matematikan (1400-1455), Leonik Tomeu (1456-1531), mendimtar dhe përkthyes i autorëve të antikitetit grek, Mikel Maruli (1453-1500), poet i njohur për epigramet e tij të shkruara në latinisht dhe himnet për natyrën. (Mark Marku)

LETËRSIA E KOSOVËS. Letërsia shqipe e Kosovës është pjesë e traditës dhe e zhvillimit kulturor nacional. Dëshmi e parë letrare është vepra e Brocardus Monacusi "Directorium ad passagium" (1332). Mirëpo, letërsia shqiptare nis me dokumentet e shek. XV, "Formula e pagëzimit" (1462) e Pal Engjëllit e "Fjalori i Arnold von Harfit" (1496). Në shek. XVI vijon shkrimi shqip me "Mesharin" (1555) e Gjon Buzukut dhe me "E mbsueme e krështerë" (1592) të Lekë Matrëngës. Pastaj kemi "Fjalorin latinisht-shqip" të Frang Bardhit (1635) e "Doktrina e krishtenë" (1618) të Pjetër Budit, i cili është poeti i parë me rreth 3,000 vargje origjinale, ku përmend edhe Pal Hasin e shek. XV, i cili kishte shkruar himnin "Dita e Gjqit". Në këtë traditë Pjetër Bogdani boton veprën "Çeta e profetëve" (Cuneus Prophetarum, 1685) ku trajtohen probleme teologjike-letrare, por kemi edhe poezi origjinale. Në vijimësi kemi Gjon Nikollë Kazazin, autorin e "Katekizmit" (1743) retorik e përkushtues ndaj Zotit. Ndërkaq, poetikën orientale me tematikë shqiptare e sjell Tahir Boshnjaku me poemën "Emni Vehbie" (1835). Në shek. XIX, letërsinë shqipe e përfshin fryma e Rilindjes Nacionale, por në lidhje me hapësirën e Kosovës shquhen Ndue Bytyçi, Gjergj Fishta e Shtjefën Gjeçovi. Bytyçi, me vjeshat fetare-atdhetare në veprën "Memleqetit" (1887), Fishta me gjerësinë tematike tek epi "Lahuta e Malcis" (1902) dhe dhembjen për Kosovën te lirikat "Mrizi i zanavet" (1924) dhe Gjeçovi, etnologu që mblodhi e kodifikoi "Kanunin e

Lekë Dukagjinit” (1933). Tradita e përbashkët e krijimit dhe komunikimit letrar vështirësohet mbas viteve 1912-1913 kur Kosova mbeti jashtë hartës shtetërore shqiptare. Në periudhën historike 1912-1945 në Kosovë hetojmë dy rryma krijimtare: alhamiadon e autorëve Haxhi Ymer Lutfi Paçarrizit, Sheh Hilmi Maliqit e Tahir efendi Llukës dhe letërsinë sociale të autorëve Esad Mekuli dhe Hivzi Sulejmani. Mbas vitit 1945 fillon letërsia e re mbi traditën e vjetër letrare. Hapet revista “Jeta e re” (1949), e cila ishte ditare e autorëve të rinj. Ndërkohë, Martin Camaj, i ikur nga Shqipëria, botoi veprën romantike-rustikale “Nji fyell ndër male” (1953) për t’u ndjekur nga vepra e lirikës sociale “Për ty” (1953) e Esad Mekulit, autorë që do të shihen si modele letrare në Kosovë. Mbas veprave poetike kemi prozën me autorët Hivzi Sulejmani “Njerëzit” (1951), Zekeria Rexha “Talush Efendia” (1951-1956), Sitki Imami “Drejt ditëve të reja” (1953), ku arti letrar, kryesisht, u shkrua si edukim ideologjik. Në vitet ‘60-’70 dominon poezia, e cila trajton temat personale, ideologjike e universale si përshtatje me evoluimin sociopolitik. Hetohet ngjashmëri stili, por edhe lojë formash e simbolesh. Në këtë plejadë janë Enver Gjerqeku, Din Mehmeti, Adem Gajtani, Fahredin Gunga, Azem Shkreli, Rrahman Dedaj, Ali Podrimja etj. Por shquhen dy romancierë të metonimisë ambientale, Adem Demaçi e Nazmi Rrahmani. Pas demonstratave të vitit 1968 u lejua flamuri kombëtar, u hap Universiteti i Prishtinës (1970), u miratua Kushtetuta e vitit 1974 dhe Kosova u forcua si semi-republikë. Prishtina u bë qendër gravituese intelektuale shqiptare në ish-Jugosllavi, filloi komunikimi me Tiranën dhe hapja ndaj dijeve perëndimore. Letërsia shqipe në Kosovë integroi përjasjen me letërsitë e tjera, rinjohjen me traditën, forcimin poetik-estetik si dhe refuzimin ideologjik. Këtë frymë moderne letrare në vitet ‘70 e konsoliduan autorët: Anton Pashku, Beqir Musliu, Rexhep Qosja, Teki Dervishi, Musa Ramadani, Eqrem Basha, Sabri Hamiti, Zejnullah Rrahmani, Jusuf Gërvalla, Qerim Arifi, Mehmet Kraja, Nexhat Halimi, Jusuf Buxhovi, Edi Shukriu, Ibrahim Kadriu etj. Poezia theu klishetë didaktike, duke integruar refleksivitet metaforik. Proza pasurohet me lojën e prizmeve narrative e strukturore. Drama e nisur me autorët: Hivzi Sulejmani, Xhemil Doda, Kristë Berisha, e arbëneshi Josip

Rela, avancoi drejt stileve e kompozicioneve moderne me autorët: Anton Pashku, Rexhep Qosja, Azem Shkreli, Teki Dervishi, Beqir Musliu etj. Kjo shumësi krijuese përcillet nga studiuesit: Ali Aliu, Rexhep Qosja, Ibrahim Rugova, Sabri Hamiti, Rexhep Ismajli, Mensur Raifi etj., të cilët sollën teoritë e metodat euroamerikane në hetimin e fenomeneve dhe të teksteve letrare. Ndërkaq, Redaksia e “Rilindjes” forcoi botimin e veprave të traditës shqiptare, të autorëve të rinj dhe të veprave të letërsisë dhe kritikës botërore. Ky vrull letrar krijoi brezin vijues të autorëve të viteve ‘80: Arif Demolli, Avdullah Konushevc, Ramadan Musliu, Basri Capriqi, Ibrahim Berisha, Milazim Krasniqi, Adem Gashi etj., të cilët e pasuruan korpusin letrar me vepra poetike, prozaike e dramatike. Agresioni serb u ringjall në vitet ‘80, me sulme antiidentitare, duke kulmuar më 1989 me shuarjen e institucioneve të Kosovës. Harku kohor 1989-1999, me gjithë okupimin klasik të Kosovës e më pastaj edhe konfliktin e luftën e viteve 1998-1999, nuk mbetet pa emra krijuesish. Shquhen Halil Matoshi, Migjen Kelmendi, Kujtim Rrahmani, Beqë Cufaj etj., të cilët realizojnë forma poetike e prozaike si mozaiqe diskursesh, qoftë edhe si poetikë e postmodernizmit. Mbas vitit 1999 e deri më sot letërsia e Kosovës, përveç autorëve të etabluar nuk pasurohet ndjeshëm me emra të rinj. Në poezi, prozë e dramë shquhen në kreacione letrare Rexhep M. Shala, Arben Idrizi, Ardian Haxhaj etj., të cilët kërkojnë format e reja të shprehjes, qoftë edhe si rivizitim i traditës letrare, aventurë shkrimore e kërkim sipas frymës postmoderne letrare. Letërsia e Kosovës, si pjesë e pandarë e letërsisë nacionale, por e kushtëzuar historikisht nga rrethanat e veçimit brenda llojit, tashmë kap traditën vetanake njëshekullore. E nisur si emancipim kulturor, pastaj me elemente të poetikës sociale e ideologjike, forcon e sforcon modernitetin në të gjitha format letrare, zhvillon kritikën dhe studimet e fuqishme letrare, për ta përjetuar edhe aventurën postmoderne në shekullin e ri. (Nysret Krasniqi)

LETËRSIA E REALIZMIT SOCIALIST. Metoda e realizmit socialist që një metodë e importuar nga Bashkimi Sovjetik, që iu imponua së jashtmi letërsisë shqipe dhe këtë e vërteton një fjalim i mbajtur në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH-së nga Enver

Hoxha në vitin 1947, titulli i të cilit është njëherësh edhe një urdhër për shkrimtarët dhe artistët: “Letërsia jonë të ecë në rrugën e realizmit socialist”. Metoda e re bëhet masë dhe kriter i vlerësimit jo vetëm i veprave që do të shkruhen pas imponimit të metodës, por edhe për veprat e traditës si dhe për gjithë veprat e letërsisë botërore. Parimet e saj janë parime kryesisht politike: partishmëria proletare, heroi pozitiv, fryma popullore, arti si pasqyrim eksplícit i realitetit. Mbikëqyrës të zbatimit të këtyre parimeve janë një sërë strukturash: redaksitë e gazetave, revistave dhe shtëpive botuese, Lidhja e Shkrimtarëve, sektori i propagandës në Komitetin Qendror të PPSH-së, Sigurimi i shtetit dhe më në fund pjesë e këtij sistemi censurues bëhet vetë lexuesi i ideologjizuar. Censura dhe terrori shumë shpejt shndërrohen në autocensurë. Në thelb, letërsia e realizmit socialist nuk është as metodë, as rrymë e as drejtim letrar. Në pjesën më të madhe, ajo është një masë e madhe tekstesh që pasi kanë hequr dorë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga funksioni estetik, kanë si funksion primar funksionin propagandistik. Tekstit letrar i ndalohej errësia, figuracioni ekstravagant, shkrimtarit i pamundësoheshin zgjedhjet krijuese alternative, temat ishin të përcaktuara. Të gjitha këto në funksion të faktit se kjo letërsi duhej t’i shërbente “ndërgjegjësimit revolucionar të masave”. Promovuesit e parë të letërsisë së realizmit socialist u bënë një grup shkrimtarësh të rinj të viteve ‘30 të cilët kishin shfaqur që më parë prirjet për një letërsi të angazhuar. Shkrimtarët që prodhuan veprat e para socrealiste, të cilat u bënë më vonë edhe modele të kanonit socrealist qenë: Shefqet Musaraj (1914-1986) me “Epopenë e Ballit Kombëtar” (1944), Dhimitër Shuteriqi (1915-2003) me romanin “Çlirimtarët” (1952) i konsideruar si romani i parë i realizmit socialist, Fatmir Gjata (1922-1989) me romanin “Kënetë” (1959), Aleks Çaçi (1916-1989) me poemën “Ashtu Myzeqe” (1947), Ali Abdihoxxha (1929-2014) me romanin “Një vjeshtë me stuhi” (1959). Veprat e tyre herë imitime të letërsisë sovjetike, herë krijime individuale ishin vepra skematike pa vlera estetike, për shkak se viheshin në mënyrë të drejtpërdrejtë në shërbim të propagandës zyrtare. Edhe ndonjë shkrimtar si Sterjo Spasse, autor i dy romaneve filozofike-sentimentaliste “Pse” (1935) dhe “Afërdita”

(1944), vepra që ndikuan në modernizimin e prozës shqipe, filloi t’ia përshtaste veprën e tij parimeve të realizmit socialist. Pasojë e këtij konvertimi qenë romanet “Ata nuk ishin vetëm” (1952), dhe “Afërdita përsëri në fshat”, (1954). Me një ndryshim të vogël nga të tjerët Llazar Siliqi (1924-2001) me poemën “Prishtina” (1949) shartonte në poezinë e tij traditën e poezisë tradicionale të poetëve shkodranë me patetizmin revolucionar të Majakovskit. Në fillim të viteve ‘60, në letërsinë shqipe u shfaq një grup shkrimtarësh të rinj që hynë në konflikt me shkrimtarët paraardhës. Shkrimtarët e rinj, më të shquarit prej të cilëve ishin Ismail Kadare, Dritëro Agolli, Fatos Arapi, Dhori Qiriazhi ishin kundër thjeshtëzimit propagandistik të letërsisë, ata ishin për një theksim të autonomisë së veprës së artit, për theksimin e funksionit estetik të letërsisë, për dominanten nacionale në letërsi, për poezinë e figurës dhe të mendimit etj. Ata nuk iu kundërvunë hapur metodës së realizmit socialist, por kërkuar revizionimin e saj. Me përjashtim të Ismail Kadaresë (1936), veprat e tyre në pjesën më të madhe mbeten vepra thellësisht ideologjike dhe në shërbim të politikës së ditës. Dritëro Agolli (1931) me romanet “Komisari Memo” (1970) “Njeriu me top” (1975) me poemën “Nënë Shqipëri” (1974) u bë shkrimtari më i rëndësishëm i realizmit socialist. Në romanin “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo” (1973), Agolli artikulon një kritikë ndaj burokratëve brenda kufirit të lejuar nga regjimi. Po ashtu Fatos Arapi me vëllimet me poezi “Poema dhe vjersha” (1966), “Drejt qindra shekujsh shkojmë” (1977), nga një anë jep modele të një poezie thellësisht militante, nga ana tjetër të një poezie liriko-meditative me vlera estetike autentike. Ismail Kadare (1936-) është një shkrimtar që edhe pse ka krijuar disa vepra që u nënshtrohen parimeve të metodës së realizmit socialist si “Shqiponjat fluturojnë lart”, apo romanet “Dasma”, “Nëntori i një kryeqyteti” (1975) dhe “Dimri i madh” (1977) nuk mund të inkuadrohet brenda metodës së realizmit socialist. Shkrimtar me talent të jashtëzakonshëm, ai e refuzon estetikisht pa e kundërshtuar hapur metodën dhe kjo vihet re në pjesën më të madhe të veprave të tij: “Gjenerali i ushtrisë së vdekur” (1963), “Përbindëshi” (1965), vepër e cila u ndalua nga censura komuniste, “Kështjella” (1970), “Kronikë në gur” (1971), “Muzgu

i perëndive të stepës” (1978), “Ura me tri harqe” (1978), “Pashallëqet e mëdha” (1978), “Brezna e Hankonatëve” (1977), “Kush e solli Doruntinën” (1979), “Viti i mbrapshtë” (1987). Me “Nëpunësin e pallatit të ëndrrave” (1981), ai shkon përtej refuzimit estetik në një kundërvënie me regjimin totalitar, kur përmes alegorisë zbulon absurdin dhe tmerrin e aparatit shtypës të regjimit, i cili synon kontrollin e gjithçkaje, madje edhe të ëndrrave të shtetasve të tij. Vepra që i shmangen deri diku metodës së realizmit socialist janë edhe romani i Petro Markos (1913-1991) “Qyteti i fundit” (1960), i Jakov Xoxës (1922-1979) “Lumi i vdekur” (1965), i Sabri Godos (1929-2011), “Ali Pashë Tepelena” (1970) dhe “Skënderbeu” (1975), i Dhimitër Xhuvanit (1934-2009) “Tuneli” (1966). (Mark Marku)

LETËRSIA E RILINDJES. Rilindja Kombëtare Shqiptare është lëvizje njëherësh kulturore dhe politike. Si lëvizje politike ajo shfaqet më vonë, ndërkohë që si lëvizje kulturore nis në fillim të shek. 19, kur një elitë kulturore bëhet e vetëdijshme për identitetin kulturor, gjuhësor dhe etnik të shqiptarëve dhe e afirmon këtë identitet përmes mbledhjes së folklorit, shkrimit të letërsisë në shqip, dhe mësimi të saj në shkolla. Letërsia e Rilindjes është letërsi identitare dhe e angazhuar, pasi është shkruar kryesisht në funksion të krijimit të kombit dhe shtetit kombëtar shqiptar. Duke qenë se nga elementët kombformues elita kulturore e Rilindjes gjeti si element përbashkues kombëtar gjuhën, racën dhe territorin, kjo letërsi funksionon si një narracion i madh dhe konstruksion mitiko-ideologjik i shenjtërimit të gjuhës, dheut (mëmë, atë), të parëve (pellazgëve dhe ilirëve) dhe si rievokim i rezistencës antiosmane me figurë qendrore Gjergj Kastriotin-Skënderbeun. Kjo përcakton edhe modelin letrar mbizotërues të kësaj periudhe. Veprat letrare janë programatike dhe shumëfunktionale ku në pjesën më të madhe funksioni estetik kalon në plan të dytë apo të fundit. Modeli i letërsisë së angazhuar dhe propagandistike kombëtare, do të mbizotëronte gjatë në letërsinë shqipe dhe po aq sa e ka ndihmuar ngjizjen e kombit, po aq e ka vonuar kalimin e letërsisë shqipe në modernitet. Rilindja Kombëtare pati qendrat e veta jashtë dhe brenda territorit ku jetonin shqiptarët, në Shkodër, Korçë, Stamboll, jug të Italisë, Bukuresht, Egjipt, Sofje, Bruksel e më vonë

edhe në qytete të tjera shqiptare dhe në SHBA. Institucionet kryesore të saj qenë shoqëritë kulturore më të rëndësishmet prej të cilave “Drita” (Stamboll 1879, Bukuresht 1881), “Dëshira” (Sofje, 1890), “Vllazëria e shqiptarëve” (Egjipt), (1897) “Agimi” (Shkodër, 1901), “Bashkimi” (Shkodër, 1899), “Vatra” (Boston, 1912). Organet e shtypit ishin gjithashtu institucione të rëndësishme: “Drita” (“Diturija”), (Stamboll, 1884-1885), “Fiamuri i Arbrit” (Kozencë, 1883-1887), “Albania”, (Bruksel, 1897-1909), “Kalendari Kombiar” (Sofje 1897-1928), “Kombi” (Boston, 1906-1908), “Dielli” (Boston, 1909). Disa akte gjuhësore, kulturore dhe përkthime për qëllime kryesisht fetare mund të konsiderohen si proto-literaturë kombëtare. Si autorë dhe akte zanafillore të kësaj protolëvizjeje mund të konsiderohen klerikët katolikë të Veriut dhe letërsia e tyre filobiblike. Rilindja si lëvizje kulturore për zgjimin e vetëdijes kombëtare nisi tek arbëreshët së pari me Dh. Kamardën, mbledhës i folklorit arbëresh. Në vitin 1794 në San Demetrio Korone u hap kolegji arbëresh, ku mësimi bëhej në arbërisht. Rilindja arbëreshe ka si figurë qendrore J. de Radën. Në vitin 1836 ai botoi “Këngët e Milosaos”, një nga veprat themeluese të letërsisë shqipe të Rilindjes, më pas poemën epike “Skënderbeu i pafan” (1872), ndërkohë botoi edhe gazetën e parë shqipe “L’albanese d’Italia” (Arbëreshi i Italisë) në vitin 1848, në Napoli. Pas De Radës spikasin poetët G. Dara, Z. Serembe, Z. Skiroi. Epiqendra e Rilindjes u bë Stambolli, ku shkrimtarë, dijetarë, klerikë, intelektualë, një pjesë e mirë e të cilëve funksionarë të aparatit burokratik perandorak, të nxitur nga lindja e lëvizjeve nacionale të vendeve të tjera të Ballkanit dhe krizat e perandorisë u angazhuan për krijimin e vetëdijes kombëtare të shqiptarëve. Në këtë grup bënin pjesë vëllezërit Frashëri, P. Vasa, H. Tahsini, I. Qemali, H. Prishtina, J. Vreto. A. Frashëri qe organizatori dhe udhëheqësi politik i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (1878), S. Frashëri, dijetar i njohur në sferat kulturore të Stambollit është autori i traktatit politik “Shqipëria, ç’ka qenë, çështje e çdo të bëhet?”, (1899), N. Frashëri, poeti kombëtar i Shqipërisë, autori i veprave themeluese të letërsisë së Rilindjes “Bagëti e Bujqësi” (1886), “Histori e Skënderbeut” (1898), “Lulet e verësë” (1890), P. Vasa, autori i poemës “O Moj Shqypni, e mjera Shqypni”, shndërruar në himn të Rilindjes. Shoqëria e Stambollit (1879), e ndaluar në vitin 1881 dhe e zhvendosur në Bukuresht

në 23 vitet e ekzistencës së saj botoi 25 libra në gjuhën shqipe, revistën “Drita” dhe një sërë shkollash në gjuhën shqipe në qytete të ndryshme të Shqipërisë. Në territoret shqiptare, falë rolit të klerit katolik, Rilindja shqiptare pati si qendër Shkodrën. Kur nisi lëvizja kombëtare shqiptare, kleri katolik ishte një elitë e konsoliduar kulturore me shkollat dhe shtypshkronjat e veta, ku mësohej shqipja dhe ku realizoheshin botime në gjuhën shqipe. P. Doçi, Gj. Fishta, A. Arapi, N. Kaçorri, Sh. Gjeçovi, N. Mjedja etj, qenë në avangardë të Rilindjes. Poemat “Vaji i bylbylit” (1888) i Mjedjes dhe “Lahuta e Malcis” (1905) e Fishtës janë ndër veprat më përfaqësuese të Letërsisë së Rilindjes. Rilindja vijoi edhe në qendra të tjera si Rumani, Egjipt dhe SHBA. Në Bukuresht, N. Vexhillharxhi botoi abetaren e parë në gjuhën shqipe më 1845. Më 1881 u formua shoqëria “Drita”-“Dituria” si degë e Shoqërisë së Stambollit. Më aktivët qenë J. Vreto, N. Naço, A. S. Drenova (autor i himnit kombëtar shqiptar). Në Egjipt, spikasin Th. Mitko dhe A. Z. Çajupi, njëri mbledhës i këngëve popullore shqiptare “Bleta shqiptare” (1878), tjetri poet i njohur me përmbledhjen poetike “Baba Tomori”, (1902). Më vonë në SHBA konsolidohet një fraksion i Rilindjes me protagonistë F. Konicën, S. Pecin dhe F. Nolin. Konica i cili që në Bruksel ishte shfaqur si protagonist i rëndësishëm i Rilindjes me revistën “Albania” dhe me publicistikën e tij, Peci si themelues i “Kombit” botuar më 1906 në Boston dhe Noli, si publicist, përkthyes, kryeredaktor i “Diellit” dhe themeluesi i Kishës Autoqefale Shqiptare kontribuan fort në Lëvizjen dhe Letërsinë e Rilindjes. (Mark Marku)

LETËRSIA E VJETËR SHQIPE (FILOBLIKE). Kundërreformacioni shënon programin e Kishës universale të Romës që fjala e Zotit të thuhet në gjuhët kombëtare të vendeve të vogla. Për më tepër zhvillimi i gjuhëve kombëtare u pa si mjet për të mbajtur popujt në gjirin e katolicizmit. Kjo është një betejë mendore kundër luterizmit dhe islamizmit në vendet ku këto lëvizje e rrezikonin katolicizmin. Në këtë mënyrë ndodhitë kishtarë e religjioze ndikuan në letërsi. Të kësaj periudhe janë dhe veprat e para të botuara në shqip. Vargu i autorëve: Gjon Buzuku (1555), Lekë Matranga (1560-1619), Pjetër Budi (1566-1622), Frang Bardhi (1606-1643), Pjetër Bogdani (1630-1689) krijojnë një lëvizje mendore dhe një ndërgjegje kulturore. Këta autorë me veprat e tyre: “Meshari”

(1555) i Buzukut, “E mbësue me e kërshterë” (1592) e Matrangës, “Doktrina e Kërshenë” (1618), “Rituali roman” (1621) e “Pasëqyra e rrrëfyemit” (1621) të Budit, “Dictionarium latino-epiroticum” (1635) e “Skënderbeu” (1636) të Bardhit e “Cuneus prophetarum” (Çeta e profetëve) (1685) e Bogdanit krijojnë një periudhë të shkrimit të gjuhës e të letërsisë shqipe. Ndonëse për nga mënyra e ndërtimit të tekstit dallojnë, këto vepra zotërohen nga karakteri doktrinar i krishterë, të plotësuar me elemente historike të popullit shqiptar. Duke qenë të zotëruara nga temat e kultura biblike, në porosi e në ligjërim, vetvetiu marrin cilësimin e karakterizimit të letërsisë filobiblike. Karakteri i shkrimit të tyre identitar më së fortë lidhet me nivelin e shqipes së tyre, si gjuhë e formuar kishtarë në konceptet themelore, e mbështetur në fjalor me frymën e jetës materiale të shqiptarëve. Ky element i dytë i gjuhës identitare shfaqet në paratekstet që paraqesin destinimin e librave dhe në lakimin e gjuhës në tekste të mirëfillta letrare. Kjo ngjet edhe në nivel të përkthimit, të imitimit e të adaptimit edhe në përpjekjen për të hartuar letërsi origjinale. Prandaj, autorët e vjetër të letërsisë shqipe të shekujve XVI e XVII shquhen në rrafshin e protagonistëve kulturorë e shoqërorë (edhe prijës e udhëheqës rebelimesh, Budi e Bogdani). Në rrafshin e niveleve të autorësisë krijuese dallohen si përkthyes (Buzuku e Matranga) deri në nivelin e hartimit origjinal (Bardhi, Budi e Bogdani). Gjuha e tyre, për dy shekuj, tregon nivelin e shndërrimeve të shqipes. Shkrimtaria e tyre kalon nëpër nivelet e shkrimit doktrinar fetar, në nivelin dokumentar historik e më në fund edhe filozofik e letrar. Në pikëvështrimin letrar poezitë e Budit janë indikative (dëftore) me thurje tregimtare dhe mbështetje në gjuhën e folur të gurrës popullore. Poezitë e Bogdanit kanë brenda ndërgjegjen e formës letrare dhe mbështeten në ligjërim alegorik e simbolik. Shkrimet filologjike e historike të Bardhit kanë disiplinën e provës, të diskutimit e të natyrës vërtetuese. Eqrem Çabej ka theksuar në krye të herës që këta autorë krijojnë një periudhë të parë të letërsisë shqipe. (Sabri Hamiti)

LETËRSIA MODERNE. Formacion letrar mbasromantik, me dy faza, paramoderne e moderne, që zotëron gjysmën e parë të shek. XX. Andon Zako Çajupi (1866-1930), vepra e të cilit dominohet nga fryma kritike me

procedim satirik, ngjyra humori e ironie, “Katërbëdhjetë vjeç dhëndër” (1902) e “Pas vdekjes” (1910). Veprat kryesore: “Baba Tomori” (1902), me lirika intime me ngjyrimë elegjiake e figurë popullore; “Baba Musa lakuriq” (1905), ku satira kulmon në parodi, ku ndodhitë biblike me procedim parodizues i kthen në parabola të aktualitetit. Stilin e vet të shqipes e lakon mjeshtërisht në përkthimet e veta letrare. Gjergj Fishta (1871-1940) krijoi epin nacional “Lahuta e Malcís” (1905/37) për të përjetësuar përhershmeritë shqiptare me tetërrokësh popullore të përthyer në stil individual dhe u bë poeti më i famshëm i epokës. Shkroi lirikë atdhetare e fetare me masa të vargut klasik. Sulmi i satirës së tij rroku mentalitete të kohës dhe fenomene të përhershme të shqiptarëve. Shkroi melodrama me tematika fetare e tema shqiptare dhe provoi tragjedinë klasike, “Ifigenija n’ Aulli” (1931) dhe “Juda Makabe” (1920). Ka trajtuar probleme estetike dhe probleme të kombit shqiptar duke e prodhuar formulën vetjake: atme e fe. Për së gjalli u cilësua poet kombëtar, i propozuar për çmimin Nobel për Letërsi. Aleks Stavre Drenova (1872-1947), poet, lirik i pastër. Lirizmit tradicional ia shton edhe poezinë e mendimit. Shprehjen poetike e kalon nëpër shkallët e epitetit, emërtimit e të metaforës, si trashëgimi të simbolizmit. Përpiqet të krijojë librin poetik si strukturë të “Psallme murgu” (1930). Faik Konica (1876-1942), nismëtar i modelit kritik letrar në shqip. Redaktoi revistën “Albania” ku botoi shkrimet kritike e eseistike dhe promovoi shkrimtarët e brezit të vet. Themelues i kritikës së artikulimit subjektiv e teoritizues i saj. Proza e tij nisët si poetike e mbaron si alegorike, “Një ambasadë e zulluve në Paris” (1922) e me satirë “Dr. Gjëlpera zbulon rrënjët e dramës së Mamurrasit” (1924). Ishte sistematik, por jo sistematizues. Është cilësuar si stilisti më i madh modern toskë. Vepra postume “Shqipëria - Kopshiti shkëmbor i Europës Juglindore” (1957). Fan. S. Noli (1882-1965), nis krijimtarinë me dramën “Israilitë e Filistinë” (1907), bëhet i njohur me përkthimet e kryeveprave të letërsisë botërore dhe me interpretimet e tyre në shqip. Shkroi poezi okasionale me strukturim e figura biblike të përthyer me ngjarjet e botës aktuale. Temat dhe dilemat e tij lidhen me figurën e Krishtit. Cilësohet si autor i poezisë së ideve tek “Albumi” (1948). Botoi “Autobiografinë” (1960), që bëhet

çelës për interpretimin e personës së tij. Ka botuar studime për Skënderbeun, Betovenin e Tolstoin. Midhat Frashëri (1880-1949) përpiqet të zhvillojë idetë e Frashërve në një epokë tjetër. Libri i tij i parë “Naim be Frashëri” (1901) u bë referencë për jetën dhe veprën e Naimit. Shkroi proza poetike e tregime etnike “Hi e shpuzë” (1915). Ka shkruar ese për botën shqiptare me theksime kulturore e shoqërore, “Plagët tona” (1924). Ka shkruar libra në frëngjisht për raportet historike të shqiptarëve me fqinjët. Lasgush Poradeci (1899-1987), liriku i parë modern shqiptar, që ruan një frymë poetike naimiane dhe një mjeshtri të formës të postsymbolistëve. Krijimin e poezisë e bën kult, duke e ngritur në nivel të përsosmërisë shprehjen, ritmin e rimën. Poezia e tij “Vallja e yjeve” (1933) e “Ylli i zemrës” (1937) është një libër poetik i strukturimit bodlerian, që sublimon një botë shqiptare për t’ia dhënë botës tjetër. Në strukturën e poezisë së tij mbretëron metafora. Në moshë të madhe i rimori temat e rinisë: dashurinë, fljimin, përjetësinë. Ernest Koliqi (1903-1975) kërkoi të harmonizonte temat shqiptare me stilet e epokës, në poezi e veçanërisht në prozë. Me vëllimet “Hija e maleve” (1929), “Tregtar flamujsh” (1935) e “Pasqyrat e Narçizit” (1936) u bë themeluesi i tregimit modern shqiptar. Me një stil individual portretin fisnikërinë dhe tragjikën e ambientit shkodran. Ka pasur një ndikim letrar në prozën moderne të Kosovës. Interpretues i letërsisë shqipe, duke adhuruar Fishtën e duke anuar intimisht kah stili i Mjedjes. Fitoi famë si përkthyes i poetëve të mëdhenj të Italisë. Ethem Haxhiademi (1902-1965) u bë autor i njohur me tragjeditë e trajtës klasiciste. Në strukturë e në formë. Temat e tragjedive të tij merren nga Bibla, “Abeli” (1938), historia kombëtare “Skënderbeu” (1935) dhe nga bota antike ilire “Pirrua” (1934). Në veprat e tij artikullohet thelbi tragjik, qëndrimi moral. Mitrush Kuteli (1907-1967), u bë autor i njohur me tregime dhe novela, në të cilat shkrihet stili biblik dhe stili popullor me tematika individuale e sociale. Nismëtar i tregimit modern, shfaqet në “Netë shqiptare” (1938), ndërsa kurorëzohet me “E madhe është gjëma e mëkatit - Tat Tanushi i Bubutimës” (1947). Pati ndikim në brezin pasrendës të prozatorëve shqiptarë. Është interpretues i poezisë së Poradecit dhe të Nolit. Kuteli i botoi kritikën “Shënime letrare” më 1944. Millosh Gjergj

Nikolla - Migjeni (1911-1938) shkroi poezi dhe prozë e për së gjalli botoi librin "Vargjet e lira" (1936). Pas vdekjes iu botua libri "Novelat e qytetit të veriut" (1938). Shkrimi i tij në të dy format krijon një njësi letrare substanciale. Kryengritja e tij letrare, tematike e stilistike, krijoi një prerje të fortë me autorët pararendës dhe të kohës. Dilemat e tij artikulohen shkurt e prerë edhe me referencat jetësore të prozës së tij. Këto kalojnë nga kundërshtimi e rebelimi, në fund edhe në trishtim e melankoli. Ky artist i pambaruar vdiq i ri. Musine Kokalari (1917-1983) u rrit në Gjirokastër. U diplomua për letërsi në Romë (1942). U dënua politikisht nga komunistët dhe kaloi dyzet vjet në burg dhe në internim, ku vdiq. Kokalari (Muza shqiptare), u bë autorja e parë moderne me librat në prozë: "Siç më thotë nënua plakë" (1939), "Sa u tunt jeta" (1944) e "Rreth vatrës" (1944), tregime me gjuhë të gjallë, me rrëfim mbi modelin popullor, me atmosferë, situata e karaktere. E promovoi i pari Lasgush Poradeci. (Sabri Hamiti)

LETËRSIA NË GJUHËT SLLAVE NË KOSOVË. Letërsi e serbëve, boshnjakëve dhe e malazezëve në Kosovë, e cila për një periudhë të gjatë të ish-Jugosllavisë ishte e përfshirë në letërsinë e gjuhës serbokroate, ose në letërsinë jugosllave. Insistimet për ndarje më rigoroze u bënë në dy dekadat e fundit të shekullit të kaluar, të cilat u përcollën me konflikte lufte. Nderkaq, pas Luftës së Dytë Botërore fillimet më nxitëse letrare të serbëve të Kosovës i shënuan Rade Nikoliq në poezi dhe Vuk Filipoviq në prozë, pastaj poetët V. Vukoviq dhe R. Pavloviq, novelisti P. Stefanoviq, si dhe L. Vuçkoviq, R. Zlatanoviq dhe B. Milidragoviq, me çka filloi periudha e re e poezisë serbe në Kosovë. Deri në fund të viteve '70 të shekullit të kaluar poetët që bënë emër janë R. Stojanoviq, B. Saviq dhe S. Kostiq, pastaj M. Petroviq, D. Nikoliq etj. Proza e autorëve serbë nga Kosova, në fillat e veta, është e lidhur me romanet e V. Filipoviqit, mandej janë paraqitur novelisti P. Stefanoviq, M. Jevtoviq dhe S. Stanishiq, si dhe novelisti dhe romancieri R. Stojanoviq. Shkrimtarët serbë që nga fillimi i vlimeve politike në Kosovë, janë rreshtuar në anën e regjimit dhe janë bërë mbrojtës të zjarrtë dhe zëdhënës të tij, qoftë indirekt, qoftë nëpërmjet veprave letrare. Ata kanë mbështetur qëndrimin e Beogradit jo vetëm ndaj Kosovës por edhe për luftën në Kroaci dhe Bosnjë e Hercegovinë. Shpërbërja e Jugosllavisë

dhe formimi i shtetit të pavarur të Bosnjës e Hercegovinës krijoi mundësinë që boshnjakët të ndërtojnë identitetin e tyre gjuhësor dhe kulturor. Deri në fund të shekullit njëzet poezisë boshnjake në Kosovë vulën më karakteristike i japin: F. Kajeviq, I. Markoviq-Plavnik, A. Xhogoviq, S. Idrizi, Sh. Kërciq dhe J. Rexhepagiq, poeti Mustafa Bale, në kohën më të re, si dhe autorët e parë të prozës, S. Idrizi Alabaku, Z. Zeqiroviq, M. Salkoviq, R. Fazli etj. Të zanafillës së letërsisë bashkëkohore malazeze në Kosovë janë Radovan Zogoviq dhe Dushan Kostiq. Jo vetëm për nga vendlindja, por edhe për nga krijimtaria ata janë të lidhur me realitetin kosovar të kohës së vet, që është manifestuar në mënyrë të veçantë në eposin "Këngët e Ali Binakut" të Zogoviqit. Me themelimin e Universitetit në Prishtinë (1971), u formua dhe "rrethi joformal letrar malazias", nga i cili do të afirmohen krijues si J. Sariq, P. Sariq, R. Deletiq, D. Jevriq, S. Vukanoviq M. Martinoviq S. Vlahoviq, R. Stojanoviq, Ç. Vukadinoviq, A. Rakoçeviq, Ç. Shunjeviciq etj. (Ismet Markoviq-Plavnik)

LETËRSIA PËR FËMIJË NË KOSOVË. Pjesë integrale e letërsisë së Kosovës dhe e letërsisë shqipe në përgjithësi. Ajo erdh me shenja mëvetësie dhe si e diferencuar nga letërsia në përgjithësi që nga fillimet e letërsisë sonë të shkruar. Si e tillë u zhvillua sidomos në periudhën e Rilindjes Kombëtare, me krijimet në tekstet për shkollat e para shqipe të autorëve Naum Veqilharxhi, Konstantin Kristoforidhi, Naim Frashëri, Sami Frashëri, Andon Zako Çajupi, Ndre Mjedja, Anton Xanoni, Luigj Gurakuqi, Aleksandër Stavre Drenova e të tjerë. Një segment të rëndësishëm të letërsisë së përshtatshme për moshat e reja ka qenë dhe vazhdon të jetë letërsia popullore. Nderkohë, në Kosovë letërsia për fëmijë nisi të shkruhet intensivisht pas Luftës së Dytë Botërore, me poezitë e Esat Mekulit, Mark Krasniqit, Rexhep Hoxhës, ndërkaq librat e parë për fëmijë të botuar në këtë periudhë janë "Gjethet të reja" i Rexhep Hoxhës, "Përrallat e gjyshit" i Mark Krasniqit, si dhe libri që u botua në Shkup "Vjersha të zgjedhura për fëmijë" i autorëve Mehmedali Hoxha dhe Lutfi Rusi, që të tre me të libra të botuar në vitin 1953. Për zhvillimin dhe afirmimin e vlerave të kësaj letërsie një rol të madh patën shtëpitë botuese në Prishtinë, në fillim "Mustafa Bakija" dhe "Milladin Popoviqi", pastaj edicioni i botimeve të "Rilindjes".

Ndërkaq një nxitje të veçantë për zhvillimin e saj pati edhe periodiku letrar për fëmijë “Pionieri” (Prishtinë) dhe “Gëzimi” e “Fatosi” (Shkup). Sidomos në vitet '60 të shekullit të kaluar kjo letërsi u pasurua me shumë emra autorësh dhe veprash, nga të cilët duhen përmendur: Anton Çetta, Rifat Kukaj, Vehbi Kikaj, Qamil Batalli, Ali Huruglica, Rrahman Dedaj, Agim Deva, Ymer Elshani, Adem Gajtani, Abdyl Bunjaku, Ymer Shkreli, Harjo Ulqinaku, Ibrahim Kadriu, Gani Xhafolli, Abdullah Thaçi, HasanHasani, Avdi Shala, Ymer Elshani, Arif Demolli, Islam Balaj, Jonuz Fetahaj, Qibrije Demiri, Zymber Elshani e të tjerë. Pjesë e pandashme e letërsisë për fëmijë që u krijua në Kosovë është edhe krijimtaria e frytshme e autorëve shqiptarë nga Maqedonia dhe Mali i Zi, si Fejzi Bojku, Abdylaziz Islami, Nuhi Vinca, Kalosh Çeliku, Ramadan Zejneli, Vahit Nasufi, Mustafa Spahiu, Asllan Bisha, Ibrahim Berjashi etj. E filluar me përmbledhje me poezi për fëmijë, kjo letërsi në Kosovë dhe në trevat e tjera shqiptare në ish-Jugosllavi u zhvillua edhe në të gjitha llojet e tjera letrare: fabul, tregim, përrallë, novelë, roman, pjesë teatrale etj. Nga temat dhe motivet në fillim me mbështetje në krijimtarinë tonë gojore, ajo u pasurua me tema e motive të tjera nga jeta e fëmijëve, nga shkolla, nga lufta për liri, jeta urbane, flora e fauna, me elementin fantastik, duke ushtruar kështu te fëmijët një ndikim të fuqishëm në zhvillimin e imagjinatës dhe në mësimin, edukimin dhe argëtimin e tyre. Shumë autorë të shquar të letërsisë për fëmijë, nëpërmjet përkthimeve, i sollën lexuesit shqiptar vlera të krijimtarisë për fëmijë të popujve të tjerë. Pati, po ashtu, edhe një zhvillim të mendimit kritik e studimor (Hasan Mekuli, Vehap Shita, Ali Jasiqi, Agim Deva, Ymer Elshani, Mehmet Kraja, Sylejman Sylja, Ramadan Musliu, Anton Nikë Berisha, Faik Shkodra, Xhevat Sylja, Rushit Ramabaja, Prend Buzhala, Shyqri Galica etj.). (Xhevat Sylja)

LETËRSIA POPULLORE. Përbërësit letrarë të folklorit, që përhapen dhe barten në mënyrë gojore. Është krijimtari anonime dhe bartërs brengat, aspiratat, ndjesitë, preokupimet social-psikologjike dhe përgjithësisht mendësinë e popullit. Letërsia popullore është krijuar në poezi (lirikë) dhe në prozë. Poezia popullore ka origjinë më të hershme, por edhe disa lloje të prozës popullore shquhen për origjinën e tyre të lashtë.

Lirika popullore është nga llojet më të përhapura të krijimtarisë popullore. Lloji më i vjetër i poezisë epike janë këngët legjendare, të cilat u përkasin baladave dhe eposit heroik të kreshnikëve, që lidhen me periudhën kalorësiake, para dhe pas pushtimit të Ballkanit nga osmanët. Këngët historike paraqesin qasjen e veçantë artistike ndaj ngjarjeve historike që nga periudha e hershme e mesjetës e deri në ditët tona. Këngët më të vjetra historike i përkasin Luftës së Kosovës të vitit 1389, ndërsa më pas shquhen këngët për dy pashallëqet shqiptare, atë të Shkodrës dhe të Janinës, pastaj këngët e Tanzimatit, të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit etj. Këngët historike bëjnë jetë aktive në popull edhe sot. Të tilla janë këngët që u kushtohen edhe ngjarjeve nga lufta e fundit e UÇK-së.

Proza popullore është gjithashtu e pasur me lloje, duke filluar nga ato me përbërës ironikë, siç janë përrallëzat (fabulat) dhe anekdotat e deri të llojet e prozës që shquhen për përbërës realistë, siç janë kallëzimet, tregimet novelistike, pleqnitë (tregimet juridike), meseletë etj. Vlera të veçanta artistike kanë edhe llojet e shkurtra të prozës popullore, si: fjalët e urta, gjëgjëzat, urimet, mallkimet, frazeologjia etj. Letërsia jonë popullore është botuar në shumë vëllime të veçanta si në Shqipëri, ashtu edhe në Kosovë. Dega e folklorit e Institutit Albanologjik në Prishtinë i ka botuar deri tash 28 vëllime me letërsi popullore. (Sadri Fetiu)

LETËRSIA ROMANTIKE. Romantizmi në letërsinë shqipe nis në fillim të shekullit XIX me Jeronim de Radën e kurorëzohet në fund të këtij shekulli me Naim Frashërin. Këta dy autorë të mëdhenj përfaqësojnë dy pamjet e romantizmit shqiptar. Jeronim de Rada (1814-1903) mbetet poet lirik me poemat romantike “Këngët e Milosaos” (1836), që mbetet kryevepra e tij poetike, dhe “Këngët e Serafina Topisë” (1843). Lirizmi i fuqishëm individual e subjektiv, figura origjinale poetike, fantazia romantike e pakufi në kohë e në hapësirë janë vlera letrare që nuk janë arritur në këtë nivel në vepra të tjera të këtij autori. Pikërisht me “Milosaon” De Rada bëhet autor i njohur në Europë, përtej letrave shqipe. Këtë status nuk e ka arritur as me dramën “Numidët” apo “Sofonizba” në shqip e në italisht, as me traktatin “Parime të estetikës”. “Autobiografia” (1898-1899) është vepër që shenjon jetën e tij

dhe bëhet çelës për interpretimin e veprës së tij. Romantizmi italo-shqiptar zhvillohet me autorë të tjerë. Gavril Dara i Riu (1826-1885) u bë i njohur me poemën “Kënga e sprasme e Balës”, po me tematikë historike, si reminishencë, mirëpo me thurje lirike. Zef Serembe (1844-1901), i pushtuar nga trishtimi vetanak e nga dhembja e shekullit shkruan vjersha të ndjeshme të kulluara në formë, si romantikët perëndimorë, porse artikulon edhe ky vargun sublimues: “Arbëri matanë detit na kujton/se ne të huaj jemi te ky dhe”. Françesk Anton Santori (1819-1894) me lirizëm rrëfimtar harton novela me pretendime kah forma e romancave. Santori kalon nga shkrimi në vargje në shkrim në prozë, që është kalim i madh në letërsinë arbëreshe. Këtë formë shprehjeje e përdor në romanin “Sofia e Kominiatëve” (1870-1880) dhe në dramën e njohur “Emira”. Ky autor i pari provon shqipen në prozë letrare me referencë nga jeta e arbëreshëve. Ky qark krijues sikur mbyllet në fund të shekullit XIX me poetin Zef Skiroi (1865-1927) që sistemin e vlerave të veta letrare e nis me poemën idilike “Mili e Hajdhia” (1891), vijon me veprën jetësore “Te dheu i huaj” (botim posthum 1940), një projeksion epik nacional, për ta përfunduar me veprën e fuqishme elegjiake “Mino” (1923), njërin nga veprat më të përsosura të gjithë lirikës shqipe. Skiroi autor që me fjalorin e gjuhën poetike del nga arbërishtja e zgjerohet kah një gjuhë letrare shqipe. Romantiku i madh Naim Frashëri (1846-1900), lindur e rritur në Shqipëri, punoi në qendër të perandorisë në Stamboll, kishte përvojë tjetër jetësore e kulturë tjetër letrare. Shkroi letërsi në persisht e greqisht, kultura letrare që i njihte mirë. Mirëpo shpërthimin e shkëlqimitin e vet letrar e pati në shqip, në moshën 40 -vjeçare (1886), me një seri veprash që i krijoi me një frymë. Poema bukolike “Bagëti e Bujqësija” (1886) me reminishenca kulturore të Virgjilit, u bë kryevepra e tij poetike, si strukturim letrar e si dashuri e zjarrtë për Shqipërinë e ngritur në nivel mitizimi. Tufa e lirikave “Lulet e verësë” (1890) në sa vende artikulon lirikën dashunore e intime, dhembjen për kalimin e kohës, bukurinë si dashuri, duke shkruar në kartë fjalët e gjuhës së zjarrtë. Naimi e kaloi veprën e vet në nivel të rrëfimit identitar te “Istori e Skënderbeut” (1898) e të rrëfimit historik fetar te “Qerbelaja” (1898) dhe në nivelin mediativ e filozofik te “Fletore e Bektashinjet” (1896).

Naimi e këndoi ndjesinë atdhetare në nivel të adhurimit. U bë apostull i shqiptarizms. Disa herë artin e vet e flijoj për qëllimin, por ai inauguroi një frymë të veçantë shpirtërore në poezinë shqipe, në radhë të parë me gjuhën e pastër shqipe, me fjalë e neologjizma të tij, duke e bërë gjuhë të adhuruar për pasardhësit. Gjuha shqipe e shkruar nuk është më e njëjta para e pas Naim Frashërit. Pashko Vasa (1825-1892) u bë i njohur me vjershën thirrëse “Mori Shqypni, e mjera Shqypni”, të vetmen vjershë të shkruar në shqip. Frymëzimet e veta letrare romantike i derdhi në vepra të shkruara në italisht, poezitë “Lule e gjemba” e prozën autobiografike “Burgimi im”, e në frëngjisht shkroi romanin “Bardha e Temalit” me skena nga jeta shqiptare. Po në frëngjisht botoi trajtesën “E vërteta mbi Shqipërinë e mbi shqiptarët”, që pati disa botime. Sami Frashëri (1850-1904) njeri i dy kulturave, shqipe e turke. Tërë jetën e jetoj alteritetin kulturor. Hartoi enciklopedinë turke e u bë nismëtar i zhvillimeve kulturore e letrare në Turqinë paramoderne. Botoi dramën “Besë” në turqisht, po me tematikë të jetës shqiptare. Botoi në turqisht romanin “Dashuria e Talatit me Fitneten” e vepra të tjera. Në shqip botoi gramatikën e punoi për alfabetin shqip të Stambollit. Vepra më e rëndësishme në shqip është “Shqipëria ç’ka qënë, ç’është e ç’do të bëhetë” (1899) e shkruar në qendër të perandorisë. Është traktat i shqiptarizms që shtjellon edhe në mënyrë utopike zhvillimin shqiptar, duke e kthyer në gjuhë konceptuale e duke e sublimuar ideologjinë nacionale të romantizmit shqiptar. Vepra u përkthye në gjuhë të tjera e pati ndikim të madh. Filip Shiroka (1859-1935) i mërguari i përjetshëm, shkroi lirikat e mallit për veten e për vendin e lindjes, që u botuan vonë në një vëllim “Zani i zemrës” (1933). Vijim i përmallimit naimian për atdheun e i mitizimit të tij. Romantizmi shqiptar duket që mbyllet me poetin Ndre Mjedja (1866-1937), në rini një shtegtar i madh i marrjes së dijeve e të kulturave romake klasike e filolatine e një i ngulitur në Shqipëri në burrnin e në pleqëri. Mjedja botoi poemën proromantike “Vaji i bylbylit” (1887-8), porse më vonë te “Juvenilia” (1917), e sidomos te tufat e lidhura të tingëllimeve “Liria”, “Scodra” e “Lissus” shfaqet liriku klasik, përtejromantik, qoftë për formën brilante të poezisë së tij, qoftë për tematikat shqiptare e arkishqiptare që kapërcejnë kufijtë e frymëzimeve romantike dhe lidhin klasicitetin

me modernitetin. Si mjeshtëri letrare, si kult i formës poetike, Mjedja lidh poezinë lirike të Naim Frashërit me poezinë lirike të Lasgush Poradecit. (Sabri Hamiti)

LETËRSIA TURKE NË KOSOVË. Bashkë me gjuhën dhe kulturën, Perandoria Osmane solli në Kosovë edhe letërsinë gojore, fillimisht e pranishme në reparte ushtarake dhe më pas në festa e ceremoni të ndryshme popullore. Në këtë mënyrë u hodhën themelet e letërsisë popullore turke në Kosovë. Krijime të letërsisë popullore turke u ruajtën, duke u përcjellë gojë më gojë, nga njëri brez në tjetrin deri në ditët tona. Në anën tjetër, letërsia turke në Kosovë, paralelisht me zhvillimet letrare në Turqi, zhvilloi letërsinë e divanit (përmbledhje veprash letrare), që përfshin veprat e krijuara përgjithësisht në qarqet fetare nga njerëzit e ditur. Poetët e divanit i shkruanin poezitë e tyre me alfabet arab në osmanishte. Një pjesë e madhe e këtyre dorëshkrimeve janë zhdukur, ndërsa një numër i kufizuar i tyre janë ruajtur në bibliotekat personale të intelektualëve, duke zënë vendin përkatës në letërsinë e divanit përgjithësisht. Njihën shumë poetë të letërsisë së divanit me origjinë nga Kosova, disa nga të cilët kanë lënë gjurmë në poezinë turke të divanit si: Mesihi, Suzi Çelebi, Ashëk Çelebi, Tecelli, Behari, Sai, Shemi, Suxhudi, Mehmet Tahiri etj.

Ndërkaq, letërsia moderne turke në Kosovë filloi të zhvillohej pas Luftës së Dytë Botërore. Zhvillimet pas vitit 1945 krijuan kushtet për kultivimin e një letërsie origjinale deri në ditët tona. Duke filluar nga viti 1951, ekzemplarë të botimeve të tregimeve dhe të poezive në gjuhën turke filluan t'i kishin nëpër duar të tyre edhe fëmijët turq në Kosovë. Deri në vitin 1969 poetët turq të Kosovës i botonin poezitë e tyre në gazetatat dhe revistat e Shkupit, ndërsa nga viti 1969 në Prishtinë u botua numri i parë i gazetës "Tan" (Agimi). Në 1973 filloi të dalë revista letrare, artistike, shoqërore dhe shkencore "Çevren" (Horizonti), ndërsa në muajin janar të vitit 1979 u botua edhe numri i parë i revistës për fëmijë "Kuş" (Zogu). Në dhjetor të vitit 1976, në Prizren, u botua numri i parë i revistës "Esin" (Inspirim), si vazhdim i revistës "Doğruyol." (Irfan Morina)

LETOVICA. Fshat në komunën e Bujanocit. Shtrihet në lartësi mbidetare 453 m, në kontaktin

e relievit kodrinor të zonës së Karadakut në perëndim dhe me fushën e Preshevës në lindje. Në afërsi të fshatit kalon hekurudha Beograd-Shkup, me stacionin hekurudhor, i cili tanimë nuk është në funksion. Sipas të dhënave të regjistrimit të vitit 1961, Letovica kishte 1,072 banorë, ndërsa në vitin 2002 kishte 1,544 banorë rezidentë. Ka shkollën tetëvjeçare, e cila është paralele e ndarë e shkollës fillore të fshatit Nasalcë. Popullsia merret me bujqësi dhe blegtori, ndërsa një numër i banorëve të fshatit kanë emigruar si fuqi punëtore në botën e jashtme. (Arsim Ejupi)

LETRAT ME VLERË. Letrat me vlerë të ndryshme të aksioneve janë instrumente të negociueshme, të cilat shërbejnë si dëshmi se njësitë kanë detyrime për të kryer, qoftë përmes të të hollave, të ndonjë instrumenti tjetër financiar, ose të ndonjë njësie tjetër me vlerë ekonomike. Lloje të zakonshme të letrave me vlerë janë bonot e thesarit, fletobligacionet qeveritare, fletobligacionet e korporatave, letrat komerciale dhe certifikatat e depozitave të lëshuara nga korporatat depozituese. Një letër me vlerë ofron dëshmi se një pretendim ekziston dhe përcakton afatin për pagesat e interesit dhe shlyerjet e kryegjësë. Letrat me vlerë në bazë të amortizimit përcaktojnë se pagesat e interesit dhe kryegjësë do të bëhen në këste përgjatë jetës së instrumentit. Letrat me vlerë në bazë të skontimit lëshohen në një çmim që është më i ulët sesa vlera nominale e letrës me vlerë dhe i gjithë interesi dhe kryegjësja paguhet në maturim. Në Kosovë, tregu i letrave me vlerë përbëhet kryesisht nga bonot e thesarit të emetuara nga Qeveria e Kosovës, të cilat për herë të parë filluan të emetohen më 17 janar 2012. Fillimisht bonot e thesarit kishin afat maturimi prej 3 muajsh, ndërsa në muajin gusht 2012 u paraqitën bonot e thesarit me afat maturimi prej 6 muajsh dhe pastaj në muajin tetor 2013 tregu u pasurua edhe me bonot e thesarit me afat maturimi prej 1 viti. Që nga muaji mars 2014 Qeveria e Kosovës ka filluar edhe emetimin e fletobligacioneve me afat maturimi prej 2 vitesh. (Sokol Havolli)

LEÇITJA. Është mekanizëm i sanksionimit juridik në modelin e vjetër të organizimit shoqëror të shqiptarët, me të cilin shprehet një dënim i caktuar. Lëçitja trajtohet edhe si një modalitet i besës. Është dënim shumë i rëndë

dhe thuhet se aktivizohet rrallë. “Me lëçitë domethënë me heqë dorë”, që është distancim nga një individ, ose nga ndonjë familje (shtëpi). Sipas të drejtës zakonore, shkaqet për lëçitje janë të saktësuarra dhe të sanksionuara. Kjo normë i jep të drejtë katundit, si njësi organizative e shoqërisë rurale, për të lëçitur, por jo për të shpërngulur dhunshëm. Katundit nuk i jepet e drejta të djegë, me sodomë (sodom), përkatësisht të rrënojë shtëpinë e as t'i shkulë pemët nga prona e të lëçiturit, as të dëmtojë asgjë me vlerë nga prona e një vrasësi, edhe nëse ky arratiset nga fshati për të shpëtuar dhe për t'iu shmangur ndëshkimit. Kanuni shpjegon se lëçitja ndodh në rast se dikush e refuzon lidhjen e besës me katund dhe me flamur, kur dikush “e shet” katundin e vet me “hjekësi” e me tradhti; kur dikush i përvaret, përkatësisht i bën bisht një vendimi apo një ligji; kur dikush ushtron ndonjë dhunë në katund e në flamur dhe kur dikush ushtron dhunë të paarsyeshme jashtë katundit apo jashtë flamurit të vet. Lëçitja mund të ndodhë edhe për t'i shpëtuar familja gjakmarrjes, duke e lëçitur vetëm një anëtar të familjes, pra gjakësin. Megjithatë, meqë një veprim i këtillë konsiderohej si ligështi dhe veprim jo i moralshëm për një familje, lëçitja në këtë formë ka ndodhur shumë rrallë dhe lidhet vetëm me raste dhe situatat tepër të rënda të gjakmarrjes. (Drita Halimi-Statovci)

LËVIZJA E NUMRIT TË POPULLSISË. Është tregues shumë i rëndësishëm demografik. Shpreh ndryshimet që ndodhin në popullsinë e një territori në kohë, nën ndikimin e faktorëve të ndryshëm, si: lindshmëria, vdekshmëria, migrimet, luftërat, epidemitë etj. Si e tillë, lëvizja e numrit të popullsisë paraqet madhësi të ndryshueshme në aspektin kohor dhe hapësinor. Ndër faktorët kryesorë që ndikojnë në lëvizjen e numrit të popullsisë janë ata ekonomikë, socialë, politikë etj. Ndonëse në rrethana jo të volitshme ekonomike-sociale dhe politike nëpër të cilat ka kaluar Kosova, numri i popullsisë ka shënuar rritje të vazhdueshme. Në regjistrimin e vitit 1948, Kosova kishte 733,034 banorë, në vitin 1961 ajo ka 963,988, ndërsa në vitin 1981 kishte 1,584,440 banorë. Sipas të dhënave të regjistrimit të vitit 2011 Kosova ka 1,739,825 banorë. Nga ecuria e numrit të popullsisë për periudhën 63-vjeçare, del se ajo ka shënuar rritje për 1,006,791 banorë. (Hazer Dana)

LËVIZJA KAÇAKE NË KOSOVË (1918-1928). Lëvizje çlirimtare, formë e rezistencës kundër pushtuesve të huaj. Njihet nga shek. XV-XVI, por në fillim kishte më tepër karakter ekonomik-politik. Fjala kaçak rrjedh prej dy fjalëve turke “Kaçki-akti”, që do të thotë “iku-u duk”. Pushtetet e ndryshme i dhanë emërtimit kuptim negativ, si cub, hajn, për t'i denigruar pjesëtarët e saj para popullit dhe për t'i inkriminuar para pushtetit. Në gjysmën e shek. XIX lëvizja kaçake bëhet më masive në Kosovë, duke marrë formë dhe karakter politik posaçërisht gjatë dhe pas Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, kur çetat kaçake u shndërruan në ushtri të Lidhjes. Lëvizja u forcua pas vitit 1908 e tutje kundër pushtetit osman dhe më vonë, pas viti 1912 kundër pushtuesve serbo-malazez, duke marrë karakterin e lëvizjes çlirimtare, ndërsa pas vitit 1913, kundër grabitjes së pasurisë, kundër shpërnguljes dhe kundër keqtrajtimit të popullsisë së pambrojtur. Kaçakët vepronin në çeta nga 10-30-50 deri në 100 veta, varësisht nga situata. Lëvizja vazhdoi të vepronte edhe gjatë Luftës së Parë Botërore kundër Perandorisë Austro-Hungareze dhe kundër pushtuesve bullgarë. Me formimin e Komitetit “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”, Lëvizja Kaçake u bë krahu luftarak i tij. Lëvizja Kaçake veprroi në mbarë trojet e okupuara shqiptare, që nga Dibra e deri në Sanxhak. Prijësit më të shquar të saj ishin: Azem Bejt-Galica, Sadik Rama, Ramë Vllasa, Mulla Agan Koja, Keri i Sadri Bardhit, vëllezërit Bajçinovci, Mehmet Konjuhi, Fazli Berani etj. Pjesëtarët e Lëvizjes Kaçake morën pjesë në kryengritjen e Dibrës, që u shtri deri në Malësi të Gjakovës (1913), në atë të Llapushës (mars-prill 1914), të Zhurit (1915), të Drenicës, e cila u përhap edhe në Llapushë e Dukagjin (1919) etj. Më pas lëvizja u shtri edhe në vise të tjera, deri në Manastir dhe ishte e ndarë në 13 zona veprimi. Secila zonë kishte komandantin e vet, ndërsa Azem Bejta ishte komandanti i përgjithshëm. Lëvizja bashkëpunoi edhe me lëvizjet me karakter të njëjtë në rajon, si me VMRO-në maqedonase për luftë të përbashkët kundër pushtimit serb. Lufta e Lëvizjes Kaçake ndikoi edhe në formimin e Zonës Neutrale të Junikut, të Zonës së Lirë të Drenicës me qendër në Galicë (1923-1924) si dhe të Zonës së Lirë në Dumnicë-Zagorth (1923-1924). Edhe pas shuarjes së këtyre zonave, Lëvizja

Kaçake vazhdoi deri në nëntor 1928, kur çetat i pushojnë veprimet luftarake. (Liman Rushiti)

LËVIZJA KOMBËTARE PËR ÇLIRIMIN E KOSOVËS (LKÇK). Parti politike e themeluar në vitin 1993. Gjatë viteve nëntëdhjetë e zhvilloi aktivitetin në mënyrë ilegale, për dallim nga shumica e partive të tjera politike të Kosovës, që atëbotë ishin publike. LKÇK-ja është e njohur për avokimin e rezistencës së armatosur kundër aparatit të dhunës së Serbisë në Kosovë dhe kritikës së vazhdueshme të rezistencës paqësore. Qëndrimet e Lëvizjes përhapeshin përmes fletushkës “Çlirimi”. Konsiderohet parti e orientimit ideologjik të majtë, ndërsa programi i saj identifikohet me idenë e bashkimit të trojeve shqiptare në një shtet, si pikë qendrore e platformës së saj politike. Pas çlirimit të Kosovës është rreshtuar në kuadër të koalicionit me Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), ndërsa nuk mori pjesë në zgjedhjet e vitit 2004. Si pasojë e rrymave të ndryshme rreth orientimeve strategjike dhe riformulimit të misionit në rrethanat e reja të vendit të lirë, LKÇK-ja u nda në dy parti të ndryshme, Lëvizja për Integrim dhe Bashkim (LIB) e udhëhequr nga Smajl Latifi dhe më pas nga Fadil Fazliu, si dhe Lëvizja për Bashkim (LB), e udhëhequr nga Avni Klinaku. Në maj të vitit 2011 të dy fraksionet shkrihen në Lëvizjen për Bashkim, duke hequr dilemat rreth orientimeve programore, por edhe rreth LB-së si trashëgimtare legjitime e LKÇK-së. (Ili Dugolli)

LËVIZJA KOMUNISTE JUGOSLLAVE NË KOSOVË. Partia Komuniste e Jugosllavisë (PKJ) filloi organizimet e saj në Kosovë në fundin e vitit 1929 dhe në fillim të vitit 1930. Celulat u formuan në Pejë, në vitin 1929. Në vitin 1932 formohet Komiteti i Rrethit në Prishtinë, ndërsa më 1937 edhe në Gjakovë, Prizren, Ferizaj, Mitrovicë, Gjilan etj. Në korrik të vitit 1937 në fshatin Cërni Vërh në Pejë u mbajt Konferenca e Parë e Vendit e PKJ-së për Kosovë, ku morën pjesë gjithsej 23 delegatë nga Peja, Mitrovica dhe Gjakova. Kjo ishte konferenca themelore e PKJ-së për Kosovë dhe deri në Konferencën e Pestë Nacionale (tetor 1940), PKJ-ja për Kosovë ishte e përfshirë në Komitetin Krahinor (KK) të PKJ-së për Malin e Zi, Bokë dhe Sanxhak. Konferenca e Pestë Nacionale shënoi kthesë në organizimin partiak të komunistëve në Kosovë. Me kërkesën e

delegatëve nga Kosova, në atë Konferencë u vendos që KK i Kosovës të jetë drejtpërdrejt i lidhur me Komitetin Qendror (KQ) të PKJ-së e jo nëpërmjet KK për Malin e Zi. KK i PKJ-së për Kosovë, për shkak të ndryshme, veçmas për shkak të mospërfshirjes së shqiptarëve në lëvizjen dhe organizimin komunist jugosllav, për një kohë u largua nga territori i Kosovës dhe u vendos në Mal të Zi. Më urdhër të KQ të PKJ-së, u kthye sërish në Kosovë, në Vitomiricë afër Pejës dhe aty zhvilloi aktivitetin për fillimin e kryengritjes së armatosur. Nga mesi i vitit 1942, KK i PKJ-së për Kosovë filloi të nxjerrë fletushkën “Liria” dhe “Zëri” në gjuhën shqipe dhe serbe, organ i Frontit të Përbashkët Antifashist të Kosovës, ku botoheshin shkrime propagandistike për luftë të përbashkët kundër okupatorit. Numri i anëtarëve shqiptarë të PKJ-së për Kosovën gjatë tërë Luftës Antifashiste Çlirimtare ishte simbolik. Në vitin 1941 ishin 23 anëtarë, më 1942 ishin 50, në vitin 1943-1944 ky numër ishte edhe më i vogël, ndërsa në mbarimin e luftës PKJ në Kosovë kishte gjithsej 45 anëtarë. (Daut Bislimi)

LËVIZJA KRYEZIU (1944). Lëvizje nacionaliste me orientim demokratik perëndimor. Ishte lëvizje çlirimtare e pavarur, e cila u shfaq në fillim të vitit 1944. Në krye të saj ishin vëllezërit Gani, Said dhe Hasan Kryeziu. Lider dhe komandant i forcave luftarake (afro 2,000) ishte Gani Kryeziu. Rruga që zgjodhi Lëvizja Kryeziu, ishte ajo e luftës së armatosur të shqiptarëve kundër okupatorëve, në bashkëpunim me të gjithë faktorët antifashistë në Shqipëri dhe në Kosovë. Bashkëpunoi me forcat e djathta dhe të majta, por edhe me ato të paangazhuara në formacione politike, që luftonin për avancimin e çështjes kombëtare. Lëvizja kishte synim të zhvillohej një kryengritje e përgjithshme nacionaliste në Kosovë, për t'i dhënë mundësi popullit të saj të vendoste për fatin e vet. Në bashkëpunim me oficerët britanikë, të atashuar në kuadër Shtabit të Lëvizjes, u përgatit plani i luftës kundër gjermanëve në Malësinë e Gjakovës dhe më gjerë. Luftimet kryesore i zhvilloi në Kam, Kepenek dhe në Zogaj (gusht, 1944), për të vazhduar në Vlad, Zherkë, Pac, Vagonë, Devë, Çeretë, Junik e deri në Pejë. Betejën më të përgjakshme kundër forcave fashiste e zhvilloi për çlirimin e Gjakovës (shtator, 1944). Në vjeshtën e vitit 1944, kur Lëvizja Kryeziu u bë

faktor i luftës për çlirim dhe bashkim kombëtar, u shpall armike nga komunistët jugosllavë dhe shqiptarë. Asgjësimi i Lëvizjes u bë në bashkëpunim ndërmjet udhëheqjes komuniste të Shqipërisë dhe asaj të Jugosllavisë. Lëvizja u shua pas vendosjes së pushtetit komunist në Kosovë dhe në Shqipëri. (Daut Bislimi)

LËVIZJA NACIONAL DEMOKRATIKE SHQIPTARE (LNDSH).

Lëvizje antikomuniste gjithëshqiptare, me orientim demokratik dhe properëndimor. Fillimet i ka që nga viti 1943, kur në Gjakovë u formua Komiteti Nacional-Demokratik Shqiptar, i cili kishte në program luftën antifashiste, duke u mbështetur te aleatët anglo-amerikanë dhe në krijimin e një Shqipërie demokratike, e cila do të përfshinte të gjitha trojet shqiptare. Pas depërtimit të forcave partizane në Kosovë, një pjesë e veprimtarëve nacionalistë si Halim Spahija, Ibrahim Fehmiu, kapiten Hysni Rudi, Halim Orana etj., u përpoqën të vepronin në të mirë të çështjes kombëtare edhe në kuadrin e organeve të pushtetit, që po krijoheshin nga Lëvizja Nacionalçlirimtare. Nga ana tjetër, shumë veprimtarë të tjerë, si Gjon Serreçi, Ymer Berisha, Marie Shllaku, Hajdar Maloku-Pllaneja, Ibrahim Lutfiu, Adem Gllavica, Luan Gashi, Osman Bunjaku, Ukë Sadiku, Ukshin Kovaçica e të tjerë, që nuk iu besonin premtimeve të komunistëve, kaluan në ilegalitet dhe iu bashkuan grupeve të armatosura të qëndresës. Më pas edhe veprimtarët e grupit të parë iu bashkuan grupit të dytë. Ata riorganizuan Komitetin dhe e shndërruan në organizatë politike e ushtarake ilegale me emrin Organizata Nacional Demokratike Shqiptare (ONDSH) dhe zgjodhën Komitetin Qendror (KQ) me seli në Prizren. Kryetar i parë u zgjodh Halim Spahia. Në janar të vitit 1945 u formua Komiteti Qendror i ONDSH-së për trevat shqiptare në Maqedoni, me seli në Shkup, në krye me mësuesin Hasan Bilalli. Në mars të po atij viti në Llapçevë, në kuvendin e udhëheqësve të grupeve të armatosura të Klinës, Rahovecit dhe të Gjakovës u formua “Besa Kombëtare” në krye me Ymer Berishën. Organizimi dhe veprimtaria e këtyre subjekteve u njoh si Lëvizja Nacional Demokratike Shqiptare.

Pas arrestimit të anëtarëve të KQ të ONDSH-së me seli në Prizren, “Besa Kombëtare” dhe KQ ONDSH-së me seli në Shkup mbanin barrën kryesore të organizimit të qëndresës. Në verë të vitit 1945, organizata “Besa Kombëtare”

mbante lidhje me KQ të ONDSH-së në Shkup dhe me lëvizjen e rezistencës antikomuniste në Shqipëri. LNDSH-ja që nga themelimi mbajti disa kuvende dhe dy kongrese: atë të Shkupit (1 qershor 1946) dhe të Lipovicës (25 korrik 1946). Udhëheqësit e saj u përpoqën të mbanin kontaktet me qeveritë e shteteve perëndimor përmes konsullatave britanike dhe turke në Shkup, të misionit anglez në Tiranë dhe në Zagreb.

Gjatë viteve 1946-1947, organet e pushtetit jugosllav dhe shqiptar ndërmorën një fushatë masive kundër veprimtarëve të LNDSH-së. Sipas burimeve jugosllave, gjatë asaj periudhe u zbuluan rreth njëqind anëtarë të komiteteve të rretheve të ONDSH-së, nga të cilët 14 ishin zejtarë, 45 intelektualë, 34 fshatarë të pasur e të mesëm, 2 punëtorë e 2 shtëpiake. Prej tyre, 16 u dënuan me vdekje, 58 veta me 581 vjet burgim, 32 u liruan gjatë hetimeve, kurse 3 u dënuan në mungesë. Gjithashtu u zbuluan 67 anëtarë të komiteteve të rinisë, prej të cilëve 40 ishin intelektualë dhe nxënës, 8 tregtarë, 11 zejtarë, 4 punëtorë dhe 4 amvise. Prej tyre 30 veta u dënuan me 54 vjet burgim. Sipas të dhënave zyrtare, nuk ishin zbuluar rreth 40 anëtarë të komiteteve të rinisë, kryesisht nga Gjakova dhe Rahoveci. U zbuluan njëkohësisht 181 anëtarë të komiteteve lokale, prej të cilëve 68 ishin fshatarë të pasur, 76 të mesëm, 13 të varfër, 14 tregtarë dhe 10 intelektualë. Prej këtyre të fundit 12 u dënuan me vdekje, 33 me gjithsej 404 vjet burgim dhe 1 u arratis. Nuk u zbuluan 30 anëtarë të komiteteve të vendit. (Muhamet Shatri)

LËVIZJA NACIONALÇLIRIMTARE NË KOSOVË (1941-1945).

Lëvizje antifashiste, e cila u zhvillua në Kosovë gjatë Luftës së Dytë Botërore (1941-1945) kundër pushtimit nazifashist dhe për vendosjen e sistemit komunist. Kjo lëvizje në Kosovë u zhvillua në kushte dhe rrethana krejtësisht të ndryshme, nga ç’ishin ato ndër vendet dhe popujt e tjerë të pushtuar të Europës, përfshirë edhe Shqipërinë. Me rënien e Mbretërisë Jugosllave më 1941, Kosova dhe viset e tjera shqiptare u ndanë midis dy shteteve të Boshtit, Italisë dhe Gjermanisë dhe aleatit të tyre, Bullgarisë. Pjesa më e madhe e Kosovës ishte e përfshirë në “Tokat e lirume” dhe i qe bashkëngjitur Shqipërisë së pushtuar nga Italia fashiste. Nën sundimin bullgar u përfshi një pjesë e mirë e Kosovës Lindore dhe

viset shqiptare në Maqedoni, ndërsa Mitrovica ishte përfshirë në zonën e pushtimit gjerman. Shumica e shqiptarëve të Kosovës e kishin shqetësim kryesor qëndrueshmërinë e kësaj gjendjeje dhe jo ndryshimin e saj sa më të shpejtë. Duke qenë se kishin vuajtur gjatë nën Mbretërinë Jugosllave, kosovarët e përjetuan si çlirim pushtimin italian dhe gjerman, ndërsa ata që kishin mbetur nën sundimin bullgar, aspironin t'u bashkëngjiteshin "Tokave të lirume". Prandaj organizimin kryesor luftarak kosovarët e bënë në mbrojtje të kufirit nga sulmet serbe, përfshirë edhe zonat e Bihorit dhe Novi Pazarit, të Plavës e Gucisë, që gjithashtu konsideroheshin pjesë e Kosovës. Ky organizim u bë së pari me vendimet e Lidhjen e Dytë të Prizrenit (1943) dhe më pas me organizimet e Lëvizjes Nacional-Demokratike Shqiptare në fund të luftës dhe menjëherë pas saj (1945-1946).

Për shkak të këtyre rrethanave, numri i komunistëve ndër shqiptarët e Kosovës, të cilët kishin marrë përsipër organizimin e LNÇ-së ishte jashtëzakonisht i vogël. Ndaj bartësve të lëvizjes antifashiste dhe ndaj komunistëve në mënyrë të veçantë, ekzistonte një mosbesim i madh (ndonëse shumica syresh ishin arsimuar në Shqipëri) për shkak të bashkëpunimit të tyre me komunistët serbë.

LNÇ-ja në Kosovë filloi me organizime grupesh të vogla, të cilët bënë sabotime, atentate dhe punë politike dhe propaganduese në terren. Qëllimi ishte që në lëvizje të përfshiheshin sa më shumë shqiptarë, të cilët mbanin qëndrim refuzues ose të rezervuar ndaj veprimeve dhe organizimeve të këtilla. Në këtë drejtim iu kushtua vëmendje demaskimit të propagandës fashiste: propagandohej lufta e përbashkët e shqiptarëve dhe e serbëve kundër pushtuesve, duke premtuar se në të ardhmen nuk do të kishte më diskriminim dhe, në disa raste, premtuhej bashkim i Kosovës me Shqipërinë. Megjithatë, qendra të organizimit komunist mbetën vendbanimet e banuara me serbë, përfshirë edhe Vitomiricën afër Pejës, prej nga koordinoheshin 5 komitetet vendore dhe 37 celulat partiake në mbarë Kosovën. Por deri në prill të vitit 1943 komunistët e Kosovës, as serbë dhe as shqiptarë, nuk patën ndonjë lidhje me organet drejtuese të Partisë Komuniste të Jugosllavisë (PKJ). Forcimi i lidhjeve me organet qendrore partiake të Jugosllavisë do ta ndryshojë rrënjësisht situatën në Kosovë. Kjo

dëshmon dy gjëra: e para, se deri në fillimin e përgatitjeve për mbajtjen e Mbledhjes së Parë të AVNOJ-it (nëntor 1943), kur u vendos që Jugosllavia e re të mbetej në kufijtë e Jugosllavisë së vjetër, për vetë udhëheqësit e komunistëve jugosllavë pozita e Kosovës nuk ishte e qartë; dhe e dyta, se disa komunistë shqiptarë të Kosovës, përfshirë edhe vetë Rezolutën e Bujanit kishin propaganduar iluzione të kota. Nga kjo periudhë, nga viti 1943 dhe prapa, kur nga qendra iu dha mbështetje e fuqishme elementit serb në parti dhe përkrasve të tyre shqiptarë, brenda LNÇ-së në Kosovë u diferencuan qartë dy rryma: njëra projugosllave, ku bënë pjesë serbët, malazetët dhe mbështetësit e tyre shqiptarë; dhe tjetra, proshqiptare, ku bënë pjesë nacionalistët shqiptarë dhe disa idealistë. Kjo ndarje e thellë u hetua qartë edhe në Konferencën e Bujanit dhe në Rezolutën e miratuar me atë rast, sikundër edhe në zhvillimet e mëvonshme në Kosovë. Shumica e nacionalistëve shqiptarë të LNÇ-së u vranë menjëherë pas Konferencës së Bujanit, ose deri në fund të luftës dhe pas saj. (Izber Hoti)

LËVIZJA PËR BASHKIM (LB). Parti politike e Kosovës. U formua më 17 maj 2008 si bashkim vullnetar i individëve me bindje të njëjtë politike, pa dallim feje, shtrese shoqërore, shkallë arsimore, me synim bashkimi e trojeve shqiptare dhe të popullit shqiptar në një shtet të përbashkët. Sipas LB-së, bashkimin kombëtar e territorial shihet si i mundshëm, kurse pavarësia e Kosovës nuk kundrohet si proces i mbylljes së çështjes shqiptare. Zgjidhjen përfundimtare të çështjes shqiptare anëtarët e kësaj partie e shohin të mundshme dhe të realizueshme qoftë në mënyrë paqësore, qoftë me opsione të tjera. Lëvizja për Bashkim ka shtrirje në tërë territorin e Republikës së Kosovës, ndërsa selinë e ka në Prishtinë. Ka strukturën e saj udhëheqëse: kryetarin, këshillin e përgjithshëm (64 anëtarë) dhe kryesinë (15 anëtarë). Në zgjedhjet parlamentare të mbajtura 2014, Lëvizja për Bashkim ka garuar në koalicion parazgjedhor me Partin Demokratike të Kosovës dhe u përfaqësua në Qeveri me udhëheqjen e Ministrisë së Diasporës. (Osman Ismaili)

LËVIZJA PËR BASHKIMIN E TOKAVE TË PUSHTUARA SHQIPTARE (1941). Lëvizje gjatë Luftës së Dytë Botërore, e cila synonte

bashkimin e të gjitha trojeve shqiptare me “Tokat e lirume”, siç quhej Shqipëria nën okupimin italian. Pas pushtimit të Jugosllavisë nga Italia dhe Gjermania në prill të vitit 1941, një pjesë e madhe e territoreve shqiptare iu bashkuan Shqipërisë. Jashtë “Tokave të lirume” mbeti Mitrovica nën pushtimin gjerman, pastaj Kaçaniku, Gjilani, Kosova Lindore dhe trevat shqiptare në Maqedoni, që iu bashkëngjitën zonës së pushtimit bullgar. Pas një sërë marrëveshesh dhe vendimesh, në maj të vitit 1941 u vendos që vija e demarkacionit mes territorit të kontrolluar nga italianët dhe gjermanët do të vendosej në Mitrovicë, ku qyteti me rrethinë do të ishte nën pushtimin gjerman. Ndërkohë, italianët mbështetën fuqishëm zhvillimin e lëvizjeve nacionaliste shqiptare, të cilat përkrahnin idenë e bashkimit të trojeve shqiptare me shtetin shqiptar. Në këto nisma u angazhuan fillimisht Mustafa Kruja, Sejfi Vllamasi e Qazim Koculli, të cilët më 7 prill i dërguan telegram Musolinit, ku kërkuan bashkimin e Shqipërisë me Kosovën. Me synim të njëjtë, kryeministri i atëhershëm shqiptar, Shefqet Vërlaci, angazhoi një komision të përbërë nga Fejzi Alizoti, Mustafa Kruja, Xhemil Dino, Dhimitër Berati e Tahir Shtylla, të cilët dorëzuan në Romë një përkujtesë, ku paraqiteshin pretendimet për kufijtë etnikë të Shqipërisë. Të njëjtës iniciativë iu bashkëngjitën Bedri Pejani dhe Rexhep Mitrovica, si udhëheqës të Komitetit të Kosovës, e më pastaj edhe Ferhat Draga dhe i biri i tij, Ali Draga, si dhe Hilmi Leka. Këta të fundit vepronin përmes Lidhjes Popullore Shqiptare të udhëhequr nga Ali Draga, nga e cila Ferhat Draga në tetor të vitit 1941 i shkroi një letër mbretit italian Viktor Emanueli III, me të cilën kërkonte ndihmë për çlirimin e Kosovës dhe bashkimin e saj me Shqipërinë. Lëvizje të këtilla për bashkimin e tokave shqiptare pati edhe në zonat bullgare të pushtimit. (Mrika Limani)

LËVIZJA POPULLORE E KOSOVËS (LPK). Parti shqiptare në ilegalitet në kohën e ish-Jugosllavisë. U formua më 17 shkurt 1982, si Lëvizja Popullore për Republikën e Kosovës (LPRK). Deri në vitin 1999 ishte e ndjekur nga policia serbe, për çka u detyrua të vepronte fshehtas. LPRK-ja ishte e organizuar në diasporë dhe në të gjitha hapësirat shqiptare në ish- Jugosllavi. Ka botuar organin e saj “Zëri

i Kosovës”. Programi dhe Statuti i partisë u miratuan në mbledhjen e parë të përgjithshme të LPRK-së, të mbajtur në korrik të vitit 1987. Bazë për këto dokumente shërbyen “Tezat e Frontit Popullor për Republikën e Kosovës”. Partia pësoi ndryshime gjatë mbledhjeve të përgjithshme të viteve 1989, 1991, 1993, 2000 dhe 2002. LPRK-ja veproi për shkëputjen e Kosovës nga Jugosllavia dhe Serbia. Më 1993, në Zvicër, me vendim të Kryesisë së LPK-së u themelua fondi “Vendlindja thërret”, pas dështimit të përpjekjeve që me fondin e Qeverisë së Kosovës në mërgim të fillojnë aksionet e armatosura për çlirimin e Kosovës. Më 28-29 korrik 1993, në Lagjen “Kodra e Trimave” në Prishtinë u mbajt mbledhja IV e përgjithshme e LPRK-së, në të cilën me programin e partisë u aprovua fillimi i luftës së armatosur, si mënyrë e vetme për çlirimin e Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare në ish-Jugosllavi. Me rezolutën e aprovuar lufta e armatosur duhej të ishte prioritet i veprimeve të LPRK-së, ndërsa emri i partisë u ndryshua nga Lëvizja Popullore për Republikën e Kosovës (LPRK) në Lëvizja Popullore e Kosovës (LPK). Ndërkaq, në mbledhjen e përgjithshme të LPK-së, mbajtur në tetor të vitit 1999, u vendos për vazhdimësinë e aktivitetit të Lëvizjes si parti politike me emrin Partia e Progresit Demokratik të Kosovës (më vonë Partia Demokratike e Kosovës). Një pjesë e anëtarësisë së LPK-së vazhdoi të veprojë edhe pas vitit 2000, si subjekt politik i veçantë, duke e ruajtur emrin e vjetër Lëvizja Popullore e Kosovës, me kryetar Emrush Xhemajlin. (Ali Cenaj)

LIBERALIZIMI I VIZAVE TË BE-së PËR KOSOVËN. Proces përmes të cilit synohet realizimi i së drejtës së qytetarëve të Kosovës që pa viza të udhëtojnë brenda kufijve të “Zonës Shengen”. Synimi i lirisë së lëvizjes është përfshirë në agjendën e Selanikut (2003) dhe është zotim i BE-së ndaj të gjitha vendeve të Ballkanit Perëndimor. Si vendi i fundit i pavarësuar gjatë procesit të shpërbërjes së ish-Jugosllavisë, Kosova është i vetmi vend i Ballkanit Perëndimor që ende nuk ka arritur t’i përmbushë të gjitha kushtet e parashtruara dhe të mundësojë udhëtimin pa viza për bartësit e pasaportës kosovare. Institucionet kosovare kanë zbatuar një varg reformash, si parakusht që në janar të vitit 2012 të fillojë



SELIA E BASHKIMIT EUROPIAN NË PRISHTINË
 dialogu për liberalizim të vizave. Në qershor të vitit 2012 Komisioni European u ka dorëzuar institucioneve kosovare “Udhërrëfyesin për liberalizim të vizave”, në të cilin paraqiten kushtet teknike që duhen përmbushur para marrjes së vendimit për liberalizim të vizave. Çështja e liberalizimit është shndërruar në një ndër preokupimet kryesore të opinionit të gjerë, duke qenë pjesë e agjendës zgjedhore, të premtimeve të shumta dhe kritikave të vazhdueshme për mosrealizim të gjertanishëm. Deri në fund të vitit 2016 Kosova nuk e fitoi regjimin e qarkullimit pa viza në BE. (Ili Dugolli)

LIDHJA DEMOKRATIKE E DARDANISË (LDD). Parti politike e themeluar në vitin 2007, nga një grup që ishte ndarë nga Lidhja Demokratike e Kosovës, me në krye Nexhat Dacin. Sipas orientimeve programore, LDD-ja është parti e qendrës së djathtë, e cila e mbështet veprimtarinë e saj në filozofinë politike të Ibrahim Rugovës. LDD-ja kishte strukturat e saj në gjithë territorin e Republikës së Kosovës. Organet më të larta qendrore të LDD-së ishin konventa e partisë, këshilli kombëtar, kryetari dhe kryesia. Për herë të parë LDD-ja mori pjesë në zgjedhjet e përgjithshme dhe ato lokale, që u organizuan njëkohësisht në nëntor të vitit 2007. Në zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, LDD-ja hyri së bashku (koalicion parazgjedhor) me Partinë Shqiptare Demokristiane të Kosovës dhe fitoi 11 ulëse

në Kuvendin e Kosovës, kurse në zgjedhjet e përgjithshme të jashtëzakonshme të vitit 2010 nuk arriti ta kalojë pragun zgjedhor. (Osman Ismaili)

LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVËS (LDK). Partia e parë politike postkomuniste në Kosovë. E themeluar në Prishtinë më 23 dhjetor 1989, ishte partia politike më e madhe e Kosovës, e cila fitoi dy zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale të Kosovës para lufte (1992 dhe 1998) dhe zgjedhjet parlamentare në Kosovën e pasluftës (2001-2004). LDK-ja u formua si bashkim i intelektualëve dhe i popullit të Kosovës, në kohën kur po shpërbëhej Lidhja Komuniste e Kosovës. LDK-ja u angazhua për një Kosovë të pavarur, demokratike dhe të lirë. Nisma për krijimin e LDK-së rrodhi nga një grup intelektualësh, shkrimtarësh e gazetarësh të Kosovës. Grupi nismëtar gjatë muajve tetor-nëntor 1989 u zgjerua edhe me persona të tjerë, si mjekë, profesorë, juristë etj. Në dhjetor të vitit 1989 u hartua programi dhe statuti i partisë, ndërkaq në kuvendin themelues të 23 dhjetorit 1989, u aprovuan dokumentet partiake dhe u zgjodh kryesia e LDK-së me këtë përbërje: Ibrahim Rugova (kryetar), Jusuf Buxhovi (sekretar), dhe anëtarë të kryesisë: Fehmi Agani, Bujar Bukoshi, Ali Aliu, Nekibe Kelmendi dhe Mehmet Kraja. Më 25 dhjetor 1989 kërkesa për regjistrimin e LDK-së si parti politike u dërgua në Ministrinë Federative të Drejtësisë të ish-Jugosllavisë, e cila e regjistroi LDK-në si partinë e parë postkomuniste në Kosovë. Që nga themelimi e deri në janar 2006, kryetar i LDK-së ishte Ibrahim Rugova. Pas vdekjes së tij kryetar u zgjodh dr. Fatmir Sejdiu (2007-2011), ndërkaq nga viti 2011 e deri më sot kryetar i LDK-së është Isa Mustafa. Që nga themelimi e deri në çlirimin e Kosovës (1989-1999), LDK-ja ishte më shumë lëvizje popullore sesa parti politike, duke udhëhequr politikisht rezistencën kundër pushtimit serb dhe duke institucionalizuar sistemin e rezistencës shqiptare në Kosovë me institucionet e krijuara në të gjitha fushat.

Pas luftës së vitit 1999 LDK-ja u profilizua si parti politike e qendrës së djathtë, e afërt me ideologjinë e partive të djathta europiane (partitë popullore europiane). Prej fillimit e deri më 2007 LDK-ja ishte forca kryesore politike në Kosovë. Ajo fitoi zgjedhjet e zhvilluara në Kosovë, si ato lokale ashtu edhe

parlamentare, në vitet 2000, 2001, 2002 dhe 2004. LDK-ja shënoi një rënie të lehtë të elektoratit kohë pas kohe, ndërsa pas vdekjes së Ibrahim Rugovës, një pjesë e partisë u nda dhe formoi një parti të re politike (Lidhjen Demokratike të Dardanisë), gjë që u reflektua edhe me humbje të elektoratit. Në zgjedhjet e para parlamentare të pasluftës (2001) LDK-ja me 48% të votave të fituara kishte hyrë në koalicion të gjerë me PDK-në (26%) dhe AAK (7%). Ndërsa pas zgjedhjeve të vitit 2004 formoi koalicion qeveritar me AAK-në (për t'i dhënë AAK-së postin e kryeministrit), duke lënë PDK-në në opozitë. Pas vdekjes së kryetarit Ibrahim Rugova (njëkohësisht edhe president i Kosovës) nga janari i vitit 2006, LDK-ja u udhëhoq nga Fatmir Sejdiu. Pas zgjedhjeve të 2007-ës, LDK-ja hyn në koalicion me partinë e saj rivale, PDK-në, koalicion që u prish pas dorëheqjes së Fatmir Sejdiut nga posti i presidentit të Kosovës. Në kuvendin e partisë, i cili u mbajt në nëntor të vitit 2010, kryetar i LDK-së me shumicën e votave të delegatëve u zgjodh Isa Mustafa. Në zgjedhjet nacionale që pasuan në dhjetor 2010, LDK-ja fitoi 27 mandate deputetësh dhe për herë të parë kaloi në opozitë. (Blerim Reka)

LIDHJA E ARSIMTARËVE SHQIPTARË “NAIM FRASHËRI”. Organizatë e arsimtarëve shqiptarë të Kosovës, të trevave shqiptare në ish-Jugosllavi dhe të diasporës. U themelua më 12. 12. 1990. Lidhja e Arsimtarëve Shqiptarë (LASH) u themelua për t'u përballuar me diskriminimin dhe represionin serb mbi arsimin dhe shkollën shqipe, me qëllim të mbijetesës, organizimit dhe pavarësimit të tyre nga sistemi i arsimit të Serbisë. LASH-i organizoi degët dhe nëndegët e veta brenda dhe jashtë Kosovës. Mori përgjegjësinë dhe ishte forca kryesore për organizimin e arsimit shqip në të gjitha nivelet e shkollimit prej vitit 1990-1999. Iu kundërvu ligjeve dhe plan-programeve diskriminuese serbe, u angazhua për përgatitjen e akteve të reja ligjore për mëkëmbjen e sistemit të pavarur të arsimit shqip në Kosovë, për përgatitjen e planeve, programeve dhe teksteve të reja mësimore, për zbatimin dokumentacionit zyrtar të Republikës së Kosovës në fushën e arsimit. U bënë hapat e parë për njësimin e planeve, programeve dhe teksteve mësimore të Kosovës me Shqipërinë. LASH-i bëri përgatitjet për

pranimin e nxënësve dhe të kuadrit arsimor në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar, bëri emërtimin ose riemërtimin e shumë shkollave fillore dhe të mesme në Kosovë, përfaqësoi arsimin kosovar në shumë takime ndërkombëtare. (Rexhep Osmani)

LIDHJA E DYTË E PRIZRENIT (1943-1944).

Organizatë politike dhe ushtarake gjatë Luftës së Dytë Botërore në Kosovë, e organizuar sipas shembullit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. U angazhua për mbrojtjen e trojeve shqiptare dhe mbetjen e tyre në shtetin e përbashkët, pas ndryshimeve politike që ndodhën pas kapitullimit të Italisë (8 shtator 1943). Ideatorë të kësaj organizate ishin Xhafer Deva, Asllan Boletini etj. Kuvendi themelues u mbajt në Prizren, më 16-20 shtator 1943, me pjesëmarrjen e 45 përfaqësuesve nga Ohri, Struga, Gostivari, Dibra, Shkupi, Tetova, Prizreni, Sharri, Theranda, Kolesjani, Rahoveci, Gjlani, Prishtina, Ferizaj, Mitrovica, Rugova, Peja, Istogu, Drenica, Novi-Pazari, Sjenica, Rozhaja, Tutini, Plava, Gucia, Gjakova dhe Malësia e Gjakovës. Kuvendi zgjodhi Komitetin Qendror (KQ) me këtë përbërje: kryetar Rexhep Mitrovica, nënkryetar Musa Shehzade dhe anëtarë: Tahir Zajmi, Asllan Boletini, Kol Margjini, Sheh Hasani, Qazim Bllaca. Ai miratoi edhe procedurën e zgjedhjes së delegatëve që do të përfaqësonin Kosovën dhe trevat e tjera shqiptare në Asamblenë Kombëtare, që do të thirrej në Tiranë më 16 tetor 1943. Kuvendi autorizoi Xhafer Devën, Aqif Blytën dhe Ibrahim Lutfiun të koordinonin punën e Lidhjes së Dytë të Prizrenit me atë të Qeverisë Shqiptare, rreth çështjes së Kosovës. Me propozimin e Tahir Zajmit, kuvendi themelues shpalli bashkimin e Kosovës, Dibrës, Tetovës, Strugës, Ulqinit dhe Tuzit me Shqipërinë, kërkoi përfshirjen brenda saj edhe të Mitrovicës dhe viseve të tjera shqiptare nën pushtimin gjerman, si dhe rishikimin e vijës kufitare me Bullgarinë dhe Malin e Zi. Në Kuvend u trajtua edhe çështja e organizimit politik dhe ushtarak, marrja e masave mbrojtëse kundër depërtimit të forcave çetnike dhe partizane nga Mali i Zi dhe Serbia. Kuvendi i dytë i Lidhjes, që u mbajt në janar të vitit 1944, zgjeroi KQ të organizatës në 14 anëtarë, zgjodhi kryetar Bedri Pejanin, sepse R. Mitrovica u ngarkua me formimin e qeverisë në Tiranë. U miratua statuti i organizatës, sipas të

cilit Lidhja e Dytë e Prizrenit do të punonte për mbrojtjen e “tokave të lirueme”, siç u quajtën viset shqiptare që iu bashkuan Shqipërisë dhe do të formojë komitetet e nënprefekturave, të komunave dhe të fshatrave. Organi më i lartë i Lidhjes ishte kuvendi, në të cilin kishte nga një përfaqësues secili rreth. Organizata kishte organin e saj “Lidhja e Prizrenit”, të cilin e botonte Komiteti i Intelektualëve Shqiptarë, i përbërë nga Kudret Kokoshi, Selman Riza, Ibrahim Fehmiu, Durmish Celina etj. Më 15-17 mars 1944 në Rogovë të Hasit Lidhja mbajti tubimin për krijimin e formacioneve ushtarake për mbrojtje të Kosovës. Komanda gjermane, edhe pse nuk e miratoi këtë propozim, lejoi formimin e një divizioni me emrin “Skënderbeg”, efektiv i të cilit, për shkak të mospranimit të të rinjve shqiptarë për t’u përfshirë në radhët e tij, nuk u plotësua as me rekrutë dhe as me kuadrin komandues. Për këtë arsye dhe për shkak të dezertimeve, në tetor 1944 divizioni u shndërrua në grup luftarak. Kuvendi i tretë i Lidhjes së Dytë të Prizrenit, që u mbajt në qershor 1944, shkarkoi Bedri Pejanin nga detyra e kryetarit të KQ dhe në vend të tij zgjodhi Xhafer Devën, ministër i brendshëm në qeverinë e Tiranës. Me nismën e Lidhjes, në shtator të vitit 1944 u themelua Komiteti i Rinisë Nacionaliste Shqiptare për Mbrojtjen e Atdheut dhe të Kombit Shqiptar, në krye me Adem Gllavicën. Organizata kishte për detyrë mobilizimin e rinisë për mbrojtjen e kufijve të shtetit shqiptar. Në këtë tubim avokati Idriz Shahmani paraqiti referatin mbi rrezikun nga komunizmi për Shqipërinë Etnike. Mbi këtë bazë u aprovua programi politik-ushtarak “Disiplinari i Rinisë Nacionaliste Shqiptare për Mbrojtjen e Atdheut dhe të Kombit Shqiptar” dhe u zgjodh KQ i Rinisë Nacionaliste me këtë përbërje: Adem Gllavica (kryetar), Sali Vala-Saçani, Luan Gashi, Avdyl Henci, Shahsivar Aliu, Fuat Muharremi, anëtarë. Për drejtimin e formacioneve ushtarake të vullnetarëve të rinj u formua komanda e përgjithshme, e cila kryesohej nga Shahsivar Aliu. Kjo komandë organizoi katër zona operative: e para, në sektorin Ferizaj-Kaçanik-Gjilan; e dyta, në atë Prishtinë-Lipjan-Podujevë; e treta, në rajonin Mitrovicë-Vushtrri-Skënderaj dhe e katërta përfshinte Rrafshin e Dukagjinit. Në periudhën shtator-nëntor 1944, forcat vullnetare të Lidhjes së Dytë të Prizrenit morën pjesë në luftime të ashpra veçanërisht në sektorët Ferizaj-Kaçanik-

Gjilan, Prishtinë-Lipjan-Podujevë, Mitrovicë-Vushtrri-Skënderaj dhe Rozhajë-Plavë-Guci. Lidhja e Dytë e Prizrenit zhvilloi veprimtarinë ushtarake dhe politike deri në mesin e nëntorit 1944, kur forcat e saj u thyen nga formacionet partizane jugosllave, kosovare dhe bullgare, ndërsa një pjesë e krerëve të saj u detyruan të largoheshin nga vendi. Veprimtarët e saj që mbetën në Kosovë ose që kaluan në Shqipëri patën një fund tragjik, si rrjedhojë e terrorit të pushtetit komunist. Të tjerët, që emigruan në vende të ndryshme të botës, zhvilluan aktivitetet atdhetar dhe antikomunist. (Muhamet Shatri)

LIDHJA E DYTË E PRIZRENIT NË MËRGIM (1962). Organizatë politike në emigracion, konsiderohet vazhduese e Lidhjes së Dytë të Prizrenit. U përtëri më 1962 në Nju-Jork nga emigrantët shqiptarë në krye me Rexhep Krasniqin. Udhëhiqej nga Xhafer Deva, deri në vdekjen e tij në vitin 1978. Lidhja mbajti kongresin e parë më 16-27 nëntor 1966 në Nju-Jork, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të organizmave politike nacionaliste në Perëndim dhe të personaliteteve të shquara të mërgatës shqiptare. Në kongres u miratua statuti i organizatës, kryetar u zgjodh Xhafer Deva, nënkryetarë Tahir Zajmi dhe Hysen Tërpeza, sekretar i përgjithshëm Ismet Ukë Sadiku-Berisha. Organizata themeloi katër degë në SHBA: dy në Kanada dhe nga një degë në Gjermani, Belgjikë, Francë, Itali, Australi dhe Turqi. Për tejkalimin e divergjencave brenda organizatës patën rol të rëndësishëm Mehmet Rashkoci në kongresin e Parë dhe Kalosh Hamdia në kongresin e dytë (26-27 nëntor 1971 po në Nju-Jork). Organi i saj “Lidhja e Prizrenit” pasqyrore pozitën e rëndë të shqiptarëve në Kosovë dhe në trevat e tjera dhe propagandohej lufta për çlirimin dhe për bashkimin e trojeve shqiptare me Shqipërinë. Për shkak të këtij përcaktimi programor, kundër Lidhjes zhvilluan fushatë si Beogradi, ashtu edhe Tirana zyrtare. Pas vdekjes së Xhafer Devës, në kongresin III (20-21 nëntor 1982) kryetar i saj u zgjodh Ismet Ukë Berisha, sekretar i përgjithshëm Tomë Nikollë Mrijaj, pozita të cilat i mbajnë edhe sot. Në këtë kongres u vendos që emri i organizatës të ishte Lidhja Shqiptare e Prizrenit. Ajo organizoi demonstrata në vazhdimësi, nga viti 1979 e deri më 2008 kundër shkeljes së të drejtave të njeriut në Kosovë dhe në trevat e tjera

shqiptare. Drejtuesit e kësaj kanë informuar vazhdimisht administratën e SHBA-së dhe të OKB-së për gjendjen e shqiptarëve të Kosovës si dhe të viseve të tjera në Maqedoni, Mal të Zi dhe Serbi. (Muhamet Shatri)

LIDHJA E KOMUNISTËVE TË KOSOVËS (LKK). Partia e vetme në pushtet në sistemin monist jugosllav në Kosovë. LKK-ja ka qenë emërtim për organizatën krahinore të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë, e cila ishte në pushtet nga viti 1944 deri në vitin 1990. Pas Luftës së Dytë Botërore, fillimisht nga një degë e partisë së centralizuar komuniste që quhej Lidhja Komuniste e Jugosllavisë (LKJ), në vitin 1952 do të riemërohet si Lidhje e Komunistëve të Kosovës, ndërsa, vetëm pas Plenumit të Brionëve të vitit 1966 kjo organizatë partiake do të fitojë një lloj të autonomisë. Në suaza të proceseve transformuese, në Plenumin e Komitetit qendror të LK-së (1 korrik 1967), u bënë ndërrime të caktuara në mënyrën dhe në format e organizimit partiak. U konstituuan konferencat e Lidhjes së Komunistëve edhe në organizatat punuese, por edhe territorialisht, në kuadër të organizatave komunale gjithashtu u aplikua konferenca e përbërë prej delegatëve me mandat dyvjeçar. Në vitet 1981-1989 në Kosovë është zbatuar dy herë gjendja e jashtëzakonshme mbi bazën e vlerësimeve ideologjike të LKJ-së dhe të LKK-së, se në Kosovë pati “tentim për kundërrevolucion”. Nga ish-Komiteti Qendror i LKJ-së u nxor platforma politike, si bazë për diferencimin ideopolitik në Kosovë. Pas represionit shtetëror të regjimit të Beogradit dhe eksponentëve të tyre gjatë viteve 1981-1999, Lidhja e Komunistëve e Kosovës u shpërbë në fillim të vitit 1990. (Mazllum Baraliu)

LIDHJA E SHOQATAVE TË PEDAGOGËVE TË KOSOVËS. Organizatë profesionale e përbërë prej shoqatave të pedagogëve të Kosovës, e cila u themelua në vitin 1974. Pararendëse e saj ishte Shoqata e Pedagogëve të Kosovës, si degë e Lidhjes së Shoqatave të Pedagogëve të Serbisë, themeluar në vitin 1966. Lidhja e Shoqatave të Pedagogëve e Kosovës ishte anëtare e Lidhjes së Pedagogëve të Jugosllavisë, me të drejta të barabarta me organizatat simotra në republikat dhe krahinën e Vojvodinës. Zhvilloi aktivitet të dendur profesional-shkencor: këshillime, kon-

ferenca dhe tribuna shkencore. Anëtarë të saj morën pjesë në takime profesionale edhe jashtë Kosovës. Në vitin 1974 u themelua Lidhja e Shoqatave të Pedagogëve të Kosovës. Kjo organizatë nxori edhe revistën pedagogjike “Pedagogu” në gjuhën shqipe dhe serbe. Gjatë administratës së dhunshme serbe në vitet ’90 të shekullit të kaluar, drejtuesit e Lidhjes u angazhuan për sensibilizimin e organizmave pedagogjike-profesionale në republikat e ish-Jugosllavisë e të Vojvodinës, deri te Asociacioni Europian i Mësimdhënësve (ATEE) në Bruksel për gjendjen e vështirë të arsimit në Kosovë nën masat e dhunshme serbe. (Nijazi Zylfiu)

LIDHJA SHQIPTARE E PEJËS (1899-1900).

Organizatë politiko-ushtarake gjithëshqiptare, që u formua për të vazhduar aspiratat e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Kuvendi u mbledh në



PJESËMARRËS TË LIDHJES SHQIPTARE TË PEJËS (1899-1900)

Pejë nga 23 deri më 29 janar të vitit 1899, ku morën pjesë rreth 500 veta, kryesisht nga vilajeti i Kosovës dhe disa përfaqësues të vilajetit të Manastirit e të Janinës. Delegatët vinin nga shtresat e mesme qytetare dhe fshatare, mësues të shkollave dhe të medreseve turke, nëpunës të administratës lokale, çifligarë të mëdhenj, nëpunës të lartë, klerikë, bajraktarë etj. Kuvendi vendosi të formonte një lidhje të re shqiptare, sipas shembullit të Lidhjes së Prizrenit, që u quajt Lidhja e Pejës ose “Besa-Besë”. Kryetari i saj u zgjodh Haxhi Zeka. Qëllimi kryesor i Lidhjes ishte ruajtja e tërësisë territoriale të vendit, lufta për çlirim nga Perandoria Osmane dhe formimi i një Shqipërie autonome, ku do të përfshiheshin të katër vilajetet shqiptare. Për shkak të situatës politike jo të favorshme dhe të qëndrimit të elementëve konservatorë, Haxhi Zeka dhe përkrahësit e tij nuk i shtruan

hapur që në fillim kërkesat për autonomi, sepse mendohej se Porta e Lartë do të dërgonte forcat e veta për ta shuar Lidhjen. Kuvendi i Pejës shpalli besën, me qëllim që të ndërpriteshin gjakmarrjet ndërmjet shqiptarëve dhe të bashkoheshin për çështjen e atdheut. Në vendimet e tij parashikohej gjithashtu që Lidhja të përhapej në të gjitha krahinat e vendit. Lidhja e Pejës pati jehonë pozitive te shqiptarët brenda dhe jashtë atdheut. Me përpjekjet e Haxhi Zekës dhe të patriotëve të tjerë, Lidhja u përhap edhe në Shqipërinë e Jugut. Kuvendet që u mbajtën në Dibër dhe në Shkodër e mbështetën atë dhe i avancuan më tej kërkesat politike. Patriotët e diasporës shqiptare u bënë thirrje bashkatdhetarëve që të bashkoheshin rreth Lidhjes së Pejës dhe programit për autonomi. Mbështetje të rëndësishme i dhanë asaj sidomos shtypi shqiptar dhe shkrimet e ndryshme të rilindësve. Kuvendi i Pejës mori vendime të rëndësishme për zhvillimin e mëtejshëm të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, siç ishin Rezoluta (Kararnameja) prej 11 pikash dhe Akti i Besës prej 12 pikash, që u miratuan në mbledhjen me dyer të mbyllura të Kuvendit më 28 janar 1899 dhe u shpallën publikisht një ditë më vonë. Në vendimet e Kuvendit u shpall formimi i Lidhjes ose, sikurse quhej në Rezolutë, i Ittifakut dhe u vendos Besa ndërmjet shqiptarëve. Lidhja shihej si një organizatë e përgjithshme dhe unike kombëtare, që do të bashkonte në gjirin e saj gjithë shqiptarët, gegë e toskë, myslimanë e të krishterë. Lidhja përcaktoi si detyrë kryesore mbrojtjen e tërësisë territoriale të Shqipërisë nga çdo orvatje që Serbia, Bullgaria, Mali i Zi dhe Greqia do të ndërmerrnin për copëtimin e trojeve shqiptare. Kuvendi e vuri theksin sidomos te rreziku i aneksimit të vilajeteve shqiptare të Kosovës e të Manastirit dhe shprehu gatishmërinë për të mobilizuar gjithë shqiptarët në rast se atdheu sulmohej nga cilado anë.

Rëndësi të veçantë kishte krijimi i ushtrisë shqiptare, në radhët e së cilës menjëherë pas Kuvendit hynë më shumë se 15 mijë vullnetarë. Njësi të tilla vullnetare ushtarake, të përbëra nga mijëra veta, u vendos të formoheshin edhe në kuvendet e tubimet që u mbajtën në vilajetet e në sanxhakët e tjerë shqiptarë. Në disa vende të Shqipërisë, Lidhja krijoi institucionet e pushtetit lokal. Ajo shtriu autoritetin në vilajetin e Kosovës, Shkodrës e gradualisht edhe në vilajetin e Manastirit dhe

të Janinës. Vendimet e Lidhjes u miratuan në tubime popullore që u organizuan në krahina të ndryshme. Tubimet më të rëndësishme u mbajtën në sanxhakun e Prizrenit (1899), të vilajetit të Shkodrës (shkurt-mars), të Dibrës (shkurt-mars), Ohrit, Elbasanit (mars-maj) etj. Në vjeshtën e vitit 1899 Lidhja kaloi në aksione të qëndresës së armatosur kundër pushtetit Osman. Luftime u zhvilluan në sanxhakun e Dibrës 1899, në Shkup, Prizren, Mitrovicë e në Pejë në fillim të vitit 1900. Porta e Lartë u alarmua nga pretendimet e shqiptarëve dhe shtrirja e rezistencës së armatosur, prandaj sulltani përdori politikën e përçarjes, duke nxitur kundër saj disa nga përfaqësuesit e parisë konservatore dhe më pas përdori masa ushtarake. Pasi shtypi me dhunë Lidhjen e Pejës, pushteti osman e forcoi më tej regjimin policor dhe thelloi politikën e mohimit të të drejtave kombëtare të shqiptarëve. U ndoqën dhe u arrestuan patriotët shqiptarë, u mbyllën shkollat dhe u ndalua përhapja e librave dhe e gazetave shqipe. (Frashër Demaj)

LIDHJA SHQIPTARE E PRIZRENIT (1878-1881). Organizata e parë dhe më e rëndësishme mbarëshqiptare me karakter politik dhe ushtarak, e themeluar në Prizren më 10 qershor



NJË PËRVJETOR I LIDHJES SHQIPTARE TË PRIZRENIT

1878, e cila synoi të zbatonte programin politik të Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Lidhja e

Prizrenit u themelua në kushtet e krizës së thellë që përfshiu Perandorinë Otomane, e cila, pas humbjes së luftës me Rusinë, nën trysninë e Fuqive të Mëdha, u detyrua t'u bënte një sërë koncesionesh shteteve ballkanike, aleate të Rusisë. Pas Traktatit të Shën Stefanit (3 mars 1878), me organizimin Komitetit të Stambollit shpërthyen protesta të shumta në mbarë viset shqiptare. Edhe para formimit të Lidhjes së Prizrenit, shqiptarët kishin organizuar kryengritje dhe kishin shtruar kërkesa për më shumë të drejta politike, por ato nuk ishin marrë parasysh nga Porta e Lartë. Në anë tjetër, Fuqitë e Mëdha nuk kishin pranuar t'ua njihnin shqiptarëve të drejtën e formimit të një shteti më vete. Ky qëndrim i Fuqive të Mëdha u përsërit edhe në Kongresin e Berlinit (13 qershor 1878), në pararendje të të cilit Komiteti i Stambollit mori nismën e mbajtjes së Kuvendit Kombëtar, me delegatë nga të gjitha krahinat shqiptare. Më 10 qershor 1878 delegatët dhanë miratimin për të formuar një besëlidhje të përgjithshme me karakter politik dhe ushtarak. Programi, të cilin e kishin miratuar personalitetet e shquara para mbajtjes së Kuvendit të Përgjithshëm, në krye me Ymer Prizrenin, Abdyl Frashërin, Sylejman Vokshin, Haxhi Zekën etj., përbante tri pika kryesore: 1. Që "Lidhja Shqiptare" e formuar në Prizren ta ruante karakterin politik kombëtar e jo t'i shërbente interesave shtetërore të Portës; 2. Që Lidhja të kundërshtonte me çdo mjet shkëputjen e trojeve shqiptare; dhe 3. Që ajo të kërkonte bashkimin e viseve shqiptare në një vilajet të vetëm. Kuvendi vendosi të njoftonte me anë të një peticioni popullor Kongresin e Berlinit, që të mos i jepte asnjë pëllëmbë tokë nga atdheu i tyre asnjë shteti të huaj. Programi politik i Lidhjes më pas u plotësua me kërkesa të reja, më të qarta, të cilat e zgjeronin më shumë shkallën e autonomisë. Kuvendi i Përgjithshëm i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit i mbajtur më 17 qershor 1878 ishte organizim i Lidhjes së mirëfilltë Shqiptare e drejtuar nga Ymer Prizreni, në të cilin kuvend "Lidhja" fraksioniste e sulltanit (Abdullah Pashë Dreni, sheh Mustafë Tetova, Iljaz Pashë Dibra etj.), e quajtur "Lidhja e jonë" e asnjëherë "Lidhja Shqiptare", tentoi të bënte obstrukcion, duke ia imponuar Kuvendit për miratim Kararnamenë (Akti i vendimeve) dhe Talimatin (Udhëzimet - rregullore administrative), me të cilat dokumente Lidhja Shqiptare e Prizrenit do ta hu-

mbiste karakterin e saj kombëtar. Ky fraksion sulltanist nuk pati sukses në mbledhjen e nënshkrimeve të mjaftueshme, ashtu që fuqia e tij u përmbys që në korrik të atij viti, kur Lidhja zyrtarisht u quajt Lidhja Shqiptare e Prizrenit. Kuvendi i Përgjithshëm i dha fund punimeve, duke zgjedhur organet më të larta: Këshillin e Përgjithshëm ose Këshillin Qendror i përbërë nga 56 anëtarë dhe Komitetin Kombëtar ose Komitetin për Shpëtim Publik, me funksione ekzekutive, i përbërë nga 13 anëtarë, me kryetar Ymer Prizrenin. Strukturat kryesore të këtij pushteti qeverisës të Lidhjes Shqiptare ngriheshin duke krijuar në fillim një gjendje "dypushteti" midis Lidhjes Shqiptare dhe administratës osmane, kurse më vonë mbizotëroi pushteti i Lidhjes Shqiptare. Udhëheqësit e Lidhjes e shihnin autonominë si periudhë kalimtare drejt pavarësisë së plotë nga Porta e Lartë. Praktika ndërkombëtare, e sidomos ajo ballkanike, kishte dhënë prova të këtilla, sepse nëpër këtë rrugë kishin kaluar edhe Rumania, Serbia, Mali i Zi dhe Bullgaria, të cilat në fillim e fituan statusin e autonomisë, për të kaluar më pas në pavarësi të plotë. Ndërkohë, në fund të gushtit 1878, në Prizren arriti Mehmet Ali Pasha (Maxharri), i cili, në zbatim të vendimeve të Kongresit të Berlinit duhej t'ua dorëzonte malazezëve Plavën dhe Gucinë. Mareshali osman nuk pranoi kërkesën e krerëve të Lidhjes që të hiqte dorë nga ky synim, prandaj më 3 shtator u rrethua nga vullnetarët e Lidhjes në sarajet e Abdullah Pashë Drenit në Gjakovë dhe më 6 shtator u vra bashkë me një numër shoqëruesish dhe me vetë të zotin e sarajeve.

Në përpjekje për të ndërtuar strukturat udhëheqëse, Komiteti Kombëtar i Lidhjes formoi tri komisione: Komisionin e Punëve të Jashtme me kryetar Abdyl Frashërin; Komisionin e Punëve të Brendshme me kryetar Haxhi Shabanin (Prizrenin), i cili do të merrej me organizimin e policisë dhe do të përkujdesej për rendin; dhe Komisionin e Punëve Financiare me kryetar Sylejman Vokshin, i cili do të administronte buxhetin dhe do të siguronte mjete për blerjen e armëve dhe municioneve për ushtrinë dhe policinë e Lidhjes. Organet e Lidhjes kishin marrë masa të rrepta kundër çdo prishjeje të rregullit, kundër plaçkitjes dhe dezertimit. Në mbledhjen e Lidhjes, të mbajtur më 2 korrik 1878, u morën një varg vendimesh, ndër të cilat më të

rëndësishmet ishin: Prizreni të ishte qendër e Këshillit Qendror, prej nga do të jepen urdhrat për të gjitha viset e Shqipërisë; që anëtarët e Këshillit Qendror të zgjidhen nga delegatët e krahinave të caktuara; që Këshilli Qeverisë të kishte nënkëshillat e veta në të gjitha qytetet e Shqipërisë, të cilat do të vareshin drejtpërdrejt prej tij etj. Pos pushtetit administrativ dhe ushtarak, gjatë verës së vitit 1879 Lidhja formoi edhe pushtetin gjyqësor, ndërsa në dhjetor të vitit 1880 shpalli Qeverinë e Përkohshme, në krye të së cilës u emërua Ymer Prizreni, i cili u ngarkua me detyrën e lartë të kryetarit të Vilajetit të bashkuar. Nënkrjetar i Qeverisë u emërua Shaip Spahiu, detyra e ministrit të Punëve të Jashtme i caktua Abdyl Frashërit, ndërsa Sylejman Vokshi u ngarkua me detyrën e shefit të dikasterit të mbrojtjes dhe komandant i forcave të armatosura.

Ndërkohë, nën presionin e Fuqive të Mëdha, Perandoria Osmane e tërhoqi ushtrinë nga krahinat që i jepeshin Malit të Zi, por Plavën e Gucinë e mbajtën nën kontroll forcat e Lidhjes. Ushtria malazeze, e komanduar nga Mark Milani, ndërmori dy sulme radhazi, më 4 dhjetor 1879 dhe 7-8 janar 1880, por ushtritë e Lidhjes, të komanduara nga Ali Pashë Gucia dhe repartet e saj të udhëhequra nga Jakup Ferri u shkaktuan malazezve disfatë të rëndë. Më 12 prill 1880, Fuqitë e Mëdha vendosën që Malit të Zi, në vend të Plavës e Gucisë, t'i jepeshin Hoti e Gruda, por si nuk arriti t'i merrte as ato, u vendos t'i jepej Ulqini. Këshilli i Lidhjes vendosi të kundërshtonte me armë dorëzimin e Ulqinit, kështu që në shtator të vitit 1880, me t'u larguar ushtria turke nga qyteti, vullnetarët shqiptarë e morën atë. Disa ditë më vonë në afërsi të Ulqinit u vendos një flotë ndërkombëtare, e cila u dha ultimatium vullnetarëve ta dorëzonin qytetin. Porta e Lartë nuk i mori parasysht interesat shqiptare, por ndërmori aksion ushtarak për t'ia dorëzuar Ulqinin Malit të Zi (26 nëntor 1880). Disa muaj më vonë (25 mars 1881) Porta e Lartë nisi në drejtim të Prizrenit një ekspeditë ushtarake të përbërë prej 40 batalionesh, në krye me Dervish Pashën. Krerët e Lidhjes organizuan mbrojtjen, por nuk arritën të ndalnin përparimin e ushtrisë osmane. U zhvilluan beteja të përgjakshme më 20 prill në Shtime dhe Slivovë, por forcat e Lidhjes u thyen dhe më 24 prill 1881 ushtria osmane mori Prizrenin. Disa udhëheqës të Lidhjes u vranë,

disa u internuan e disa syresh u arrestuan dhe u dënuan. Lidhja Shqiptare e Prizrenit u thye, por nuk u shua në tërësi deri në vitin 1885. Por programi dhe synimet e saj vunë në lëvizje shqiptarët e të gjitha viseve dhe i bashkoi ata rreth idesë së çlirimit dhe të formimit të shtetit shqiptar. (Frashër Demaj)

LIGA QYTETARE SHQIPTARO-AMERIKANE (LQSHA) (1989). Organizatë politike e themeluar në Nju-Jork (SHBA) nga veprimtarë shqiptarë dhe mbështetës të tyre amerikanë, me qëllim të afirmimit, ndërkombëtarizimit dhe sensibilizimit të çështjes shqiptare, në veçanti të çështjes së Kosovës. Themelues dhe kryetar i LQSHA-së është ish-kongresisti amerikan me prejardhje nga arbëreshët e Italisë, Xhozef DioGuardi, kurse drejtore ekzekutive zonja Shirley Cloyes DioGuardi. Në LQSHA janë përfshirë veprimtarë të dalluar të çështjes shqiptare në mërgim. Gjatë viteve '90 të shek. XX, përmes shkresave dhe raporteve të ndryshme, Liga paraqiti para administratës amerikane gjendjen e rëndë të shqiptarëve të Kosovës. Përveç informimit të opinionit, Liga organizoi edhe protesta dhe demonstrata në qytete të ndryshme të SHBA-së dhe së fundi ishte mbështetëse këmbëngulëse e pavarësisë së Kosovës. (Riza Sadiku)

LIGATINAT. Ligatinat janë pjesë të sipërfaqeve tokësore, shtresat e sipërme të së cilës janë vazhdimisht të lagështa për shkak të pranisë së ujit amull ose me rrjedhje shumë të ngadalshme. Në Kosovë nuk është bërë inventarizimi i ligatinave dhe nuk dihen vlerat e tyre. Nga të dhënat e deritashme dihet vetëm për ligatinën e Hencit, që shtrihet në pjesën qendrore të Kosovës, në territorin e komunës së Lipjanit, me një sipërfaqe prej 50 ha. Është krijuar në mënyrë artificiale, në fund të viteve '60 të shekullit të kaluar, me qëllim të kultivimit të llojit të peshkut të krapit. Kjo ligatinë artificiale me anë të suksesionit ekologjik gjysmëshekullor është shndërruar dhe ka marrë karakteristikat e ligatinës natyrore me biotop të përshtatshëm për shumë lloje bimore dhe shtazore. Është krijuar nga bashkimi i ujërrjedhave të lumit të Magurës dhe Vrellës, që janë degë të lumit Sitnica, nga furnizohen basenet e peshqve. Ligatina e Hencit është e pasur me lloje të ndryshme të bimëve vaskulare, algave, invertebrorëve,

ujëtokësorëve, zvarranikëve, peshqve, e veçmas është vendbanim i rëndësishëm për shumë shpendë autoktonë dhe shtegtarë. Menaxhimi i qëndrueshëm i kësaj zone mund të ofrojë mundësi edhe për zhvillimin e aktiviteteve sportive e rekreative dhe mund të sjellë përfitime ekonomike. (Behxhet Mustafa)

LIGJET E HARMONIZUARA TË KOSOVËS ME BE-në. Tërësia e akteve normative të Kosovës të harmonizuara me të drejtën e Bashkimit Europian (BE) (“*acquis communautaire*”). Harmonizimi i ligjeve të Kosovës me BE-në është një ndër kushtet themelore që duhet të plotësohen, më qëllim të anëtarësimit në BE. Nisur nga orientimi strategjik për integrim në BE, institucionet kosovare kanë aprovuar procedura adekuate për përafrimin e legjislacionit. Pajtueshmëria e ligjeve të Kosovës me dispozitat e BE-së realizohet pothuajse gjatë gjithë fazave të ligjvënies, me rol qendror të Zyrës Ligjore në kabinetin e kryeministrit, e cila verifikon pajtueshmërinë e nismave ligjore me dispozitat e BE-së. Vlerësimi i harmonisë kalon edhe në fazat e mëvonshme, si gjatë draftimit të ligjeve, të ligjeve, të projektligjeve në Kuvend apo edhe pas miratimit të tyre. Mbizotëron vlerësimi se ligjet e Kosovës të miratuara deri më tani janë në masë solide të harmonizuara me BE-në, megjithëse arritja e harmonizimit të plotë mbetet prioritet afatgjatë nisur edhe nga vëllimi i përgjithshëm i dispozitave ligjore të BE-së, të cilat besohet se tejkalon 130,000 faqe tekst normativ. (Ilir Dugolli)

LIGJET E MINIERAVE TË NOVOBËRDËS. Në qytetin-minierë të Novobërdës kishte disa ligje që kishin për qëllim mbarëvajtjen e punëve në miniera. Ligji më i vjetër i dëshmuar është ai i despotit Stefan Lazareviq (1412), i cili nuk është ruajtur në origjinal, porse vetëm një kopjim me dorë i tij në gjysmën e dytë të shek. XVI. Si qendër e madhe urbane dhe ekonomike, Novobërda gëzonte statusin special të qytetit qysh në shek. XIV, kishte *Statutin* e hartuar në latinisht dhe Këshillin e Qytetit. Kolonia sase dhe më vonë raguzane e Novobërdës kishte një traditë juridike, veçmas për fushën e xehetarisë. Supozohet se ligjet mbi minierat, që u dekretuan më vonë nga sundimtarë serbë e osmanë, do ta kenë pasur mbështetjen mbi një ligj më të vjetër sas mbi minierat. Edhe varianti osman i ligjit mbi

minierat e Novobërdës, i dekretuar në kohën e sundimit të sulltan Sylejmanit (1520-1566) dhe i përkthyer nga dorëshkrimi cirilik serb i kohës së despotit Stefan, njihet me emrin “Kanuni Sas”, ndërsa historiografia bullgare e njeh si “Saskija zakon”. Megjithatë, është e njohur se ligjit të tij për minierat despoti Lazareviq ia kishte shtuar një parathënie, ndërsa statutit të qytetit të Novobërdës një pasthënie në formë të një statuti të ndryshuar. Kështu, ai i përvetësoi ligjet e rregullimin sas e raguzan të qytetit, por duke ua reduktuar autonominë, që novobërdasit e kishin gëzuar për afër dy shekuj dhe duke ua kufizuar ushtrimin e lirë të rriteve katolike. Në versionin serb të statutit të qytetit sanksionohej që katolikët, përkatësisht sasët, mund ta ushtronin fenë e tyre jashtë mureve të qytetit, në rastin konkret në Kishën e Shën Kollit, me një famullitar gjerman dhe pa kontakte me popullsinë tjetër. Për banoret e Novobërdës ndalohej edhe ushtrimi i disa profesioneve në fushën sociale, ndërsa kthimet nga ortodoksia në besimin latin dënoheshin me gjoba, me dëbim nga qyteti dhe me ndëshkime të rënda fizike. (Skënder Gashi)

LIGJET PUSHTUESE SERBE NË KOSOVË (1989-1999). Aktet kundërkushtetuese me të cilat u rrënuar subjektiviteti politik dhe juridik i Kosovës, përmes të të cilave pushteti serb realizoi okupimin policor dhe ushtarak të institucioneve shtetërore (politike, ekonomike, arsimore, informative) dhe të institucioneve të tjera në Kosovë. Duke aplikuar forma të ndryshme të dhunës, pushteti serb shkatërroi tërë sistemin kushtetues dhe politik në Kosovë. Në këtë mënyrë Kosova dhe shqiptarët praktikisht u vunë “jashtë ligjit dhe kushtetutës” dhe për ta u përcaktuan rregulla dhe masa të posaçme. Ligjet me të cilat Serbia rrënoi në mënyrë kundërkushtetuese subjektivitetin juridik dhe politik të Kosovës janë: Ligji mbi veprimin e organeve republikane në rrethana të jashtëzakonshme i datës 26 qershor 1990, Ligji mbi ndalimin e punës së Kuvendit të Kosovës dhe Këshillit Ekzekutiv të Kuvendit të Kosovës i datës 5 korrik 1990, Ligji mbi marrëdhëniet e punës në rrethana të jashtëzakonshme i datës 26 korrik 1990, Ligji mbi suspendimin e punës së Kryesisë së KSA të Kosovës i datës 18 mars 1991 dhe ligjet e aktet e tjera kundërkushtetuese. (Arsim Bajrami)

LIGJI AGRAR. Dokument juridik që pasqyron organizimin dhe funksionimin e bashkësive fshatare në të gjithë territoret ballkanike të Perandorisë Bizantine, përfshirë edhe trojet shqiptare. Përbëhet prej 85 nenesh, të cilat rregullonin marrëdhëniet midis fshatarëve të lirë, të ngarkuar me detyrime ndaj shtetit, në kohën e shthurjes të bashkësisë fshatare. Sipas këtij ligji fshatarët kishin pronat e tyre private (shtëpinë, bagëtinë, arat, vreshtat etj.), që mund të trashëgoheshin, të shkëmbeheshin, të ndaheshin, të jepeshin me qira, të liheshin peng, të shiteshin brenda bashkësisë. Dhunimi i pronës private ndëshkohej me zhdëmtim ose me dënime trupore (rrahje, damkosje me hekur të nxehtë etj.). Dispozitat e tij dëshmojnë edhe për ekzistencën e pronës së përbashkët të bashkësisë (kullotat, pyjet, ujërat, tokat djerrë). Bashkësia kishte një fond tokash të lira e të papunuara, që ua ndante sipas nevojave anëtarëve të saj, përmes shortit. Bashkësia kujdesej edhe për çështje të përbashkëta (shfrytëzimin e ujërave, pajtimin e barinjve që ruanin tufat e fshatit etj.). Njësia bazë shoqërore e bashkësisë ishte familja patriarkale, e cila drejtohej nga më plakun. Të parët e familjeve formonin “këshillin e pleqve”, i cili zgjidhte ngatërresat në kuadër të bashkësisë. Shumë norma dhe institucione të këtij ligji u futën në të drejtën dokesore të fshatit shqiptar, duke mbijetuar deri në kohët e reja. (Qerim Dalipi)

LIHNOVSKI Karl Maks (Karl Max Lichnowsky) (1860-1928). Diplomati, përfaqësues i Gjermanisë në Konferencën e Ambasadorëve në Londër (1912-1913). Lindi në Kreuzenort, në Shlezinë e Sipërme. Karrierën diplomatike e nisi në ambasadën gjermane në Britaninë e Madhe (1885), për ta vijuar në legatën e Bukureshtit dhe ambasadën e Vjenës (1902-1904). U rikthye në Londër në vitin 1912, tashmë në postin e ambasadorit, të cilin e ushtroi deri në vitin 1914. Me këtë cilësi përfaqësoi Gjermaninë në Konferencën e Ambasadorëve (1912-1913), ku mbështeti qëndrimin austro-hungarez dhe italian për çështjen shqiptare. Në korrik 1914 kundërshtoi politikën inkurajuese gjermane karshi luftës së Austro-Hungarisë me Serbinë, duke argumentuar se ajo do të gjeneronte një konflikt botëror, të cilin shteti i tij nuk mund ta fitonte. Opinione dhe analizat e tij si ambasador në Londër i përmbledhën në librin “Misioni im në Londër, 1912-1914”

(Meine Londoner Mission), i cili në vitin 1916 qarkulloi privatisht në rrethet e larta politike gjermane. Botimi i pamfletit më 1918 në SHBA, ndonëse pa lejen e autorit, solli dëbimin e tij nga Dhoma Prusiane e Lordëve. Në Konferencën e Paqes së Versajës (1919) pamfleti i Lihnovskit shërbeu si burim kryesor informues për shtetet e Antantës. (Ledia Dushku)

LIKA Hazbi (1972-). Veprimtar politik dhe pjesëmarrës në luftën e Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare (UÇK). Lindi në vitin 1972 në Tetovë. Kreu studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Universitetin e Tiranës. Që në moshë të re mori pjesë në lëvizjet politike për të drejtat e shqiptarëve në Maqedoni. Me fillimin e luftës për çlirimin e Kosovës u përfshi në radhët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në Rrafshin e Dukagjinit. Në vitin 2001 mori pjesë në themelimin Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare. Gjatë kësaj periudhe ishte i njohur me nofkën komandant “Çela”. Në vitin 2002, pas formimit të Bashkimi Demokratik për Integritet, u zgjodh kryetar i degës së BDI-së në Tetovë. Kreu detyra me përgjegjësi në institucionet e Republikës së Maqedonisë. Ishte kryetar i komunës së Tetovës gjatë viteve 2005-2009. (Fehari Ramadani)

LIKA Shefqet (1928-1998). Mjek, stomatolog, primarius. Lindi në Pejë. Kreu shkollimin fillor dhe të mesëm në vendlindje, studimet në Fakultetin e Stomatologjisë të Universitetit të Beogradit, (1956). Pas diplomimit u punësua në Pejë dhe është stomatologu i parë shqiptar i Kosovës. Në vitin 1958 u emërua drejtor i Shtëpisë së Shëndetit në Pejë. Mbaroi specializimin e protetikës stomatologjike gjithashtu në Beograd (1974). Dha kontribut të çmuar në zhvillimin e stomatologjisë në Pejë. Punoi me përkushtim në zhvillimin e resurseve humane dhe të infrastrukturës mjekësore në komunën e Pejës. (Osman Sejfiqaj)

LIKAJ Ramë (1971-). Inxhinier i makinerisë, profesor universitar. Lindi në Deçan. Shkollën fillore dhe të mesmen i kreu në vendlindje, ndërsa Fakultetin Teknik e kreu në Universitetin e Prishtinës (UP). Studimet pasuniversitare dhe doktoratën i kreu në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike të UP-së. Në vitin 1994 u zgjodh asistent dhe më pas merr titujt profesor asistent dhe profesor i asociuar (2011). Është autor dhe bashkautor i disa teksteve

universitare: “Përmbledhje detyrash nga rregullimi automatik (1998), “Manuali i rezistencës së metaleve” (2005) dhe “Përmbledhje detyrash nga rregullimi, organizimi dhe ekonomia e komunikacionit” (1998). Botoi një sërë punimesh shkencore dhe mori pjesë në disa simpoziume dhe konferenca shkencore dhe profesionale. (Xhevat Perjuçi)

LIKOCI. Fshat në Drenicë, rreth 15 km në jug të Skënderajt. Fshati ka relief kodrinor-malor me lartësi mbidetare 750 m. Është vendbanim i tipit të shpërndarë, me sipërfaqe kadastrale prej 714 ha. Përmes rrugës së asfaltuar në një anë lidhet me magjistralen Skënderaj-Drenas, ndërsa në anën tjetër me fshatin Rrezallë të Skënderajt. Me emrin Ljutkovce është i regjistruar në defterin kadastral të vilajetit Vëllk të vitit 1455. Derisa në vitin 1948 kishte 505 banorë, në regjistrimin e fundit (2011) ka gjithsej 1,175 banorë. Popullsia merret me bujqësi dhe blegtori. Kultivohen drithërat, pemët, perimet etj. Ka një repart industrial dhe disa njësi tregtare. Likoci është bashkësi lokale, ku gravitojnë vendbanimet: Abri e Poshtme, Açarevë, Murgë, Plluzhinë, Rrezallë dhe Ticë. Me ndarjen e re administrative (2010), Likoci ka fituar statusin e nënqendrës urbane. Ka shkollën 9-vjeçare, qendrën e mjekësisë familjare, ndërsa deri para luftës (1999) kishte edhe shtëpinë e kulturës. (Ramiz Cëravadiku)

LIKOSHANI. Fshat në Drenicë, 12 km në verilindje të Drenasit. Vendbanim i tipit të shpërndarë me sipërfaqe rreth 456 ha. Relievi kodrinor-malor, lartësia mbidetare 650 m. Me Drenasin dhe qendrat e tjera lidhet përmes rrugës së asfaltuar, ndërsa përmes Qirezit dhe Prelocit del në rrugën e magjistrale Skënderaj-Vushtrri. Me emrin Lokushani përmendet në defterin kadastral të vilajetit Vëllk të vitit 1455, ndërsa me emrin Likoshan është regjistruar në sallnamet e vilajetit të Kosovës të vitit 1893. Për shkak të migrameve të jashtme dhe të brendshme, luftërave etj., numri i popullsisë ka pësuar ndryshime të vazhdueshme. Derisa në vitin 1948 kishte 373 banorë, në regjistrimin e fundit (2011) numëron 600 banorë. Veprimtari kryesore ekonomike është bujqësia: kultivimi i drithërave, pemëve, bimëve foragjere dhe blegtoria. Likoshani është bashkësi lokale dhe ka shkollën 9-vjeçare. Në luftën e fundit 1998-1999 fshati pati humbje të mëdha në njerëz dhe

dëme ekonomike. Në vitin 1998 në këtë fshat ndodhi masakra mbi popullatën civile, e cila ishte e para në Kosovë, që regjimi serb zhvilloi ndaj popullsisë shqiptare. (Ramiz Cëravadiku)

LILA Rifat (1945-). Mjek, specialist i mjekësisë së punës, profesor universiteti. Lindi në Gjakovë, ku kreu shkollimin bazë, ndërsa Fakultetin e Mjekësisë e kreu në Novi-Sad. Fillimisht punoi në Novi-Sad, pastaj u kthye në Gjakovë, në Kombinatin e pambukut “Emin Duraku”. Në vitin 1978 filloi studimet pasuniversitare dhe specializimin nga mjekësia e punës. Është themelues i Dispanserit të Mjekësisë së Punës në Industrinë e Bashkuar të Tekstilit “Emin Duraku” (1981). Më 1980 u zgjodh anëtar i Asociacionit Ndërkombëtar të Mjekësisë Agrikulturale dhe Shëndetit Rural. Më 1984 mori titullin primarius, ndërsa më 1988 mbrojti disertacionin e doktoratës. Më 1987, për herë të parë në ish-Jugosllavi, diagnostikon te vajza 13-vjeçare ekinokokun e zembrës. Më 2004 u zgjodh ligjërues në Fakultetin Filozofik, departamenti i psikologjisë, për lëndën zgjedhore mjekësia e punës. Është autor i shumë punimeve shkencore të botuara në vend dhe në botën e jashtme. Është bartës i shumë mirënjohjeve dhe dekoratave. (Xhevat Shkodra)

LILA Xhevdet (1934-2006). Aktor. Lindi në Mitrovicë, ku edhe kreu shkollimin fillor dhe të mesëm. Në Teatrin Popullor Krahinor (TPK) u angazhua nga viti 1961. Ndër rolet e tij më të realizuara në shfaqjet e Teatrit Popullor Krahinor janë: Dushku në shfaqjen “Studentët e përjetshëm” (1965), Sokoli në dramën “Halili dhe Hajria” (1969), Valeri në komedinë “Tartufi” (1965), i shoqi në dramën “Erveheja” (1966) dhe Bushi në komedinë “Peripeçitë e kohës”. Luajti edhe në film dhe TV. Për disa vjet ishte edhe zëvendës drejtor i TPK-së. (Arian Krasniqi)

LIMAJ Fatmir (1971-). Njëri nga komandantët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), politikan. Lindi në Banjë të Malishevës. Studioi në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës. Ishte njëri nga udhëheqësit e lëvizjes studentore të viteve 1988-1990 dhe pjesëmarrës në aksionin për pajtimin e gjaqeve në Kosovë. Në vitin 1996 iu bashkua radhëve të UÇK-së. Ishte themelues i njësitit ushtarak të UÇK-së



FATMIR LIMA

“Çeliku”. Në gusht të vitit 1998 u emërua komandant i Brigadës 121 “Ismet Jashari-Kumanova”. Në territorin ku vepronte kjo brigadë, në malet e Berishës, gjatë viteve 1998-1999 gjetën strehim dhe u mbrojtën një numër i madh i të zhvendosurve. Forcat ushtarake dhe policore serbe nuk arritën asnjëherë të depërtonin në ato zona. Më 24 nëntor 1998 u emërua anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së. Ishte pjesëmarrës në shumë beteja dhe udhëheqës i operacionit më të madh luftarak të UÇK-së, operacionit “Shigjeta”, në kufirin Kosovë-Shqipëri. Mori pjesë në delegacionin e UÇK-së në bisedimet për demilitarizimin e UÇK-së dhe transformimin e saj në Trupat Mbrojtëse të Kosovës. Nga viti 2000 ishte anëtar i Këshillit Transitor të Kosovës, ndërsa më 2001 u zgjodh deputet i Kuvendit të Kosovës dhe ishte shef i grupit parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës. Më 18 shkurt 2003 u arrestua gjatë qëndrimit në Slloveni dhe u dërgua në Gjykatën e Hagës për krime lufte. Në nëntor të vitit 2005 u shpall i pafajshëm nga Tribunali i Hagës. Ishte anëtar i delegacionit të Kosovës në negociatat për statusin përfundimtar të Kosovës në Vjenë. Në periudhën 2008-2010 ishte ministër i Transportit dhe i Telekomunikacionit. Është deputet i Parlamentit të Kosovës dhe kryetar i Partisë “Nisma për Kosovën”, të cilën e themeloi në vitin 2014. (Ruzhdi Jashari)

LIMANI Adem (1953-). Mjek, otorinolarngolog, profesor universiteti. Lindi në Nesalc të Bujanocit, shkollën fillore e kreu në vendlindje, kurse gjimnazin në Preshevë. Fakultetin e Mjekësisë e kreu në Prishtinë (1977). Pas diplomimit u emërua asistent për lëndën histologji me embriologji në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë dhe më pas kaloi në Klinikën e Otorinolarngologjisë (ORL). Specializoi në




ADEM LIMANI

Qendrën Klinike Spitalore në Zagreb në citologji. Specializimin në ORL e përfundoi më 1986 në Fakultetin e Mjekësisë në Zagreb, ku

i mbaroi edhe studimet pasuniversitare. Në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë mbrojti tezën e magjistraturës dhe më pas disertacionin e doktoratës (1988). Mori titullin profesor inordinar dhe ordinar i lëndës ORL në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. Mori pjesë në shumë kongrese e simpoziume, është autor dhe bashkautor i një sërë punimesh shkencore dhe tekstesh universitare: “Kirurgjia e kokës dhe qafës, ORL” (1997), “Histologjia e njeriut” (1999). Gjatë viteve 1991-1999 ishte i përfshirë në strukturat qeverisëse të asaj kohe, duke qenë edhe pjesë e delegacioneve të shëndetësisë në takime të ndryshme në Kombet e Bashkuara dhe në forumet europiane për të dëshmuar rënimin e sistemit shëndetësor në Kosovë. Në vitet e pasluftës ushtroi funksione dhe detyra me përgjegjësi në institucionet shëndetësore. (Halil Ahmetaj)

LIMANI Ilir (1954-). Inxhinier i elektroteknikës, profesor universiteti. Lindi në Prizren, shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Prishtinë. Ndoqi studimet për inxhinieri elektrike në



ILIR LIMANI

fushën e telekomunikacionit në Lubjanë e Zagreb, kurse u diplomua në Prishtinë. Studimet e magjistraturës i kreu në Universitetin e Prishtinës, ku mbrojti dhe disertacionin (1997). Në fillim punoi në Radiotelevizionin e Prishtinës, në sektorin e valëve të mesme. Gjatë vitit 1978-1979 ishte anëtar i grupit të ekspertëve jugosllavë për alokimin e frekuencave në valë të mesme, ku kontribuoi në zgjidhjen e problemeve të mbulimit të territorit të Kosovës me këto valë. Në vitin 1979 u zgjodh asistent në Fakultetin Teknik të UP-së. Ushtrroi detyra me përgjegjësi në Fakultetin Elektroteknik, përfshirë edhe detyrën e dekanit të këtij fakulteti (1998-2002). Mori pjesë në projektimin dhe realizimin e shumë projekteve në industrinë vendore. Më 2003 mori pjesë në Bruksel si ekspert i Këshillit të Europës për vlerësimin e projekteve. Është autor dhe bashkautor i një sërë punimesh shkencore dhe profesionale, si dhe pjesëmarrës në konferenca shkencore brenda dhe jashtë vendit. Në periudhën 2008-2010 ishte këshilltar në Ministrinë e Energjetikës të Republikës së Kosovës. (Nebi Caka).

LIMANI Mufail (1964-). Gazetar. Lindi në Prishtinë, ku edhe kreu shkollimin. Publikimet e para nga fusha e letërsisë dhe gazetarisë i bëri në vitin 1980, në revistat “Zëri i rinisë” dhe “Bota e re”. Në atë kohë u mor edhe me muzikë, si pjesëtar i grupit rok “Minatori”, si bashkautor i teksteve dhe i muzikës. Në fillim të viteve ‘90 ishte ndër themeluesit e partisë politike “Parlamenti rinor”. Më pas shkroi satira dhe reportazhe në javoren “Koha”, pastaj komente në gazetën “Bujku” dhe “Fjala”. Ndërkohë, në periodikun e kohës (“Thema”, “MM” etj.) u paraqit me shkrime eseistike. Më pas ishte redaktor i kulturës në javoren “Zëri”, si dhe redaktor politik në gazetën ditore po me këtë emër. Botoi përmbledhjen e eseve dhe shkrimeve kritike “Grafite: poshtë Skënderbeu” dhe librin me proza poetike “Libër për një natë”. Punon në Radiotelevizionin e Kosovës. (Artan Krasniqi)

LIMANI Musa (1945-). Ekonomist, profesor universiteti. Lindi në fshatin Vërban të komunës së Bujanocit. Shkollën fillore e mbaroi në Preshevë, shkollën e mesme ekonomike në Gjilan dhe arsimimin e lartë e mori në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës. Titullin e magjistrisë dhe më pas të doktorit të shkencave i mori në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Zagrebit (1979). Ka kryer specializim për problemet e zhvillimit rajonal dhe të politikave zhvillimore makroekonomike në Sorbonë (1978-79). Në periudhën 1968-74 ishte i punësuar në Entin për Planifikim Shoqëror të Kosovës. Në vitin 1971 zgjidhet asistent në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës, ku punoi si pedagog deri në pensionim. Ligjëroi edhe në Universitetin e Tetovës dhe në Universitetin e Europës Juglindore. Gjatë kësaj periudhe kreu edhe disa funksione në institucionet arsimore dhe në asociacionet ekonomike, si prodekan në Fakultetin Ekonomik, kryetar i Lidhjes së Ekonomistëve Shqiptarë, anëtar i Këshillit Ekonomik Federativ të Jugosllavisë, drejtor i Institutit Ekonomik në Prishtinë, anëtar i komisionit të ekspertëve për çështje ekonomike në delegacionin e Kosovës në Konferencën e Rambujesë etj. Pub-



MUSA LIMANI

likoi shumë punime në revista shkencore brenda dhe jashtë vendit. Është autor i disa librave shkollorë dhe i teksteve universitare nga fusha e ekonomisë (“Mikroekonomia”, “Hyrje në ekonomi”, “Makroekonomia aplikative” etj.). (Myrvete Badiviku-Pantina)

LIMANI Myzafere (1954-). Inxhinierë e elektroteknikës, profesore universiteti, anëtare korrespondent e Akademisë së Shkencave dhe e Arteve të Kosovës. Lindi në Pejë, ku kreu shkollën fillore dhe të mesme. Studimet për inxhinieri elektrike i kreu në Universitetin e Prishtinës (UP) (1978), studimet pasuniversitare në Universitetin e Beogradit, ndërsa temën e disertacionit të doktoratës e mbrojti në UP



MYZAFERE LIMANI

(2000). Në fillim punoi në ndërmarrjen e Postë-telekomunikacionit në Pejë, ndërsa nga viti 1979 është pjesë e stafit mësimor të Fakultetit Elektroteknik të UP-së. Kreu disa funksione në këto institucione, përfshirë edhe detyrën e dekanit të Fakultetit Elektroteknik (2006-2012). Është autore ose bashkautore në një sërë publikimesh shkencore nga fusha e elektronikës dhe përpunimi i audiosinjaleve. Me botimet “Elektronika energjetike” (2001) dhe “Bazat e medias” (2008) u bë ndër autorët e parë në fushën e literaturës profesionale nga elektronika dhe komunikimet bashkëkohore. Është anëtare e këshillave shkencorë dhe recensues në disa revista ndërkombëtare. Është inxhinierja e parë në elektronikë dhe telekomunikacion dhe e para grua shqiptare me doktoratë në këtë fushë. (Nebi Caka).

LIMANI Remzi (1955-). Dizajner. Lindi në Shalë të Drenicës. Kreu Shkollën e Mesme të Artit në Pejë, ndërsa studimet për dizajn grafik në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. Hapi një sërë ekspozitash personale dhe mori pjesë në disa ekspozita kolektive në Kosovë dhe jashtë saj. Fitoi disa çmime dhe mirënjohje për punën e tij krijuese. Në vitin 1999 nga Senati i Akademisë Internacionale “Qyteti i Romës” u nominua kryetar artistik për Kosovë. Nga fusha e letërsisë ka botuar 14 vepra, nga të cilat dy romane, poezi, ese kritike etj. Libri me poezi

“Tinguj të humbur” u përkthye në rumunisht (2010). Aktualisht është udhëheqës i kulturës në Pallatin e Rinisë, Kulturës dhe të Sporteve në Prishtinë. (Zeni Balazhi)

LIMARI Sabri (1943-). Inxhinier i elektroteknikës, profesor universiteti. Lindi në Prizren, ku kreu shkollimin fillor dhe të mesëm, ndërsa studimet universitare dhe pasuniversitare për inxhinieri elektrike në Universitetin e Zagrebit. Mbrojti disertacionin në Fakultetin Elektroteknik të Universitetit të Prishtinës (UP) (1994). Punoi si inxhinier në ndërmarrjet elektroenergjetike (1968-1979) dhe në sektorin e zhvillimit të tyre (1980-1986). Kreu detyra menaxhuese në Elektroekonominë e Kosovës (1986-1990), si dhe udhëheqës i zyrës për zhvillim në KEK (1999-2004), ku udhëhoqi dhe koordinoi hartimin e studimeve sektoriale (Banka Botërore, Watenfall etj.). Si ekspert u angazhua në Ministrinë e Energjetikës dhe të Minierave e më pas edhe në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik për hartimin e strategjive të sektorit të energjisë së Kosovës. Ishte i angazhuar në procesin mësimor në Fakultetin Elektroteknik të UP-së për lëndët mbrojtja rele, rrjetet elektrike dhe shfrytëzimi i sistemeve elektroenergjetike. Botoi një sërë punimesh profesionale dhe shkencore në revista vendore dhe ndërkombëtare. Aktualisht jeton në Prishtinë dhe në Zagreb. (Ali Hamiti).

LIMONI Shpend (1979-). Gazetar. Lindi në Gjilan. Shkollimin bazë e kreu në vendlindje, ndërsa studimet për gjuhë dhe letërsi angleze në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës. Është njëri nga bashkëthemeluesit e “Gazetës Express”, e cila nisi të botohej në fillim të vitit 2005. Në këtë gazetë punoi si gazetar dhe redaktor i rubrikës së politikës. Gjatë vitit 2005/06, ishte pjesë e seksionit shqip të Radios “Deutsche Welle” në Bon të Gjermanisë. Me raportime ndoqi kryesisht ngjarjet dhe zhvillimet politike në vend. Ishte zëvendëskryeredaktor i portalit “Gazeta Express” dhe bashkautor i emisionit “Komiteti”, që transmetohet në TV “Dukagjini”. (Ibrahim Berisha)

LINDSHMËRIA (NATALITETI). Dukuri shumëdimensionale, afatgjate e demografike. Paraqet komponentën pozitive dhe dinamike të zhvillimit të popullsisë. Nataliteti dhe

ndryshimet në nivelin e tij paraqesin variablën qendrore të zhvillimit të drejtpërdrejtë dhe afatgjatë të lëvizjes së popullsisë, veçanërisht të lëvizjes natyrore dhe strukturës së popullsisë. Nataliteti si përcaktues kryesor i ndryshimeve demografike e shtrin ndikimin në shumë rrjedha sociale dhe ekonomike të një territori. Në periudhën para Luftës së Dytë Botërore, nataliteti në Kosovë sillej midis 35.0 dhe 50.0 promilë. Kjo do të thotë se kishte 35 deri 50 persona të lindur brenda një viti në një mijë banorë. Edhe pas Luftës së Dytë Botërore shkalla e natalitetit në Kosovë ishte e lartë, por me tendencë të rënies së vazhdueshme. Pas viteve ‘80 të shekullit të kaluar shkalla e natalitetit bie nën 30 promilë. Sipas të dhënave nga Agjencia Statistike e Kosovës, në vitin 2013 në Kosovë kanë lindur 29,327 banorë, me shkallën e lindshmërisë rreth 16 promilë. (Hazer Dana)

LIPA Dua (1995-). Këngëtare. Lindi në Londër në një familje nga Kosova e emigruar në Britani të Madhe. Në vitin 2008 bashkë me familjarët e saj qe kthyer në Prishtinë, por pas disa vitesh sërish u kthye në Londër. Karrierën muzikore e filloi në moshën 14-vjeçare. Në vitin 2015 realizoi me sukses këngën e parë të saj me titull: “New Love”, për të vijuar më pas edhe me këngë të tjera, siç janë: “Be the one”, “Last dance”, “Hotter than Hell”, “Blow your Mind” etj. Me këngët e saj është bërë e njohur në skena të ndryshme ndërkombëtare. Përpos si këngëtare, D. Lipa njihet edhe si tekstshkruese dhe modele. (Kristina Palokaj)

LIPA Seit (1937-1999). Historian. Lindi në Pejë. Shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në vendlindje, Fakultetin e Drejtësisë në Prishtinë. Në vitin 1970 u punësua në Entin e Historisë në Prishtinë, në fillim si sekretar, ndërsa më vonë kaloi në sektorin shkencor. Më 1976 mbrojti temën e magjistraturës, ndërsa më 1980 doktoratën në Fakultetin Filozofik të Prishtinës. Kreu detyra të ndryshme në organet profesionale dhe të udhëheqjes në Institutin e Historisë dhe në disa institucione arsimore-shkencore të Kosovës. Në korrik të vitit 1990 u zgjodh drejtor i Institutit të Historisë së Kosovës, më pas u shkarkua nga organet e dhunshme të Serbisë, por ai vazhdoi ta udhëhiqte Institutin deri në vitin 1995. Ka botuar studimin monografik “Kosova në periudhën e rindërtimit” (1982), ndërsa ka

lënë në dorëshkrim monografinë “Rregullimi dhe ndarja administrative e Kosovës 1945-1950”, si dhe studimin “Pushteti popullor në Kosovë 1945-1952”. Ka botuar disa kontribute shkencore dhe vështrime e kritika historiografike. (Haki Kasumi).

LIPENI. Vendbanim antik e mesjetar. Në dokumente të hershëm njihet me emrin Lypenion dhe Lypianen. Shtrihet në pjesën qendrore të Kosovës, përreth luginës së Sitnicës. Në periudhën romake ishte vendbanim i vogël pranë rrugës Lissus-Naissus dhe deri vonë mendohej se ishte Ulpiana antike, pasi në të janë konstatuar gërmadha të antikës dhe të periudhës bizantine. Lypenioni ose Lypianen përmendet te burimet historike si kala bizantine. Forma neolatine në mesjetë për qytetin Lypenion për herë të parë përmendet në tekstin grek të Vulës së Bazilit II (1019) ku thuhet: “...dhe peshkopin e Lypenionit me gjithë onorinë e tij, klerikë 15, parikë 15”, me të cilën dëshmohet prania e peshkopit dhe madhështia kishtarë e peshkopisë. (Arben Arifi)

LIPJANI. Qytet në pjesën qendrore të Rrafshit të Kosovës dhe qendër e komunës me të njëjtin emër. Ndodhet 16 km në jug të Prishtinës, në lartësinë mbidetare 550 m. Nëpër të kalojnë



LIPJANI

rrugët e rëndësishme që lidhin Prishtinën me Shkupin, Prizrenin dhe hekurudha Prishtinë-Shkup. Si vendbanim njihet që nga koha ilire, si pjesë e qytetit Ulpiana. Në dokumentet e shkruara përmendet në kartën e mbretit bizantin Vasili II në vitin 1019. Në një shkrim të princshës bizantine Ana Komnena përshkruhet pushtimi dhe djegia e Lipjanit nga ushtria serbe në vitin 1091. Në defterët

kadastralë osmanë të vitit 1445 përmendet në kuadër të Vilajetit të Prishtinës me 122 shtëpi. Deri me ndërtimin e hekurudhës Shkup-Mitrovicë (1873-1874), Lipjani ishte fshat, i njohur si udhëkryq i rrugëve në rajon. Me ndërtimin e stacionit hekurudhor, krahas të cilit u ndërtuan punëtoritë e para me karakter tregtar, depot për grumbullimin e drithërave dhe disa dyqane zejtare, Lipjani fiton pamjen e një qyteze. Ndërtimet e para individuale fillojnë në pjesën përgjatë rrugëve Prishtinë-Shtime-Ferizaj, ndërsa më vonë edhe nga jugu. Me funksionimin e hekurudhës Fushë Kosovë-Shkup-Selanik merr hov edhe zhvillimi i aktiviteteve ekonomike.

Nga viti 1918 Lipjani bëhet njësi e prefekturës së Prishtinës dhe qendër e rrethit të Sitnicës, ndërkaq me suprimimin e rretheve në vitin 1960 bëhet qendër komunale dhe në vitin 1980 shpallet qytet. Tani është qendër komunale me funksione administrative, ekonomike dhe arsimore, i pajisur me infrastrukturë dhe objekte tregtare, shërbyese, edukative-arsimore, shëndetësore etj. Në vitin 2011 kishte 6,870 banorë, ndaj 610 banorëve sa kishte në vitin 1921. (Përparim Gashi)


LIPJANI (komuna). Komunë në pjesën qendrore të Rrafshit të Kosovës, me qendër qytetin me të njëjtin emër. Shtrihet në të dy anët e lumit Sitnica, në udhëkryqin e rrugëve më të rëndësishme të rajonit, aksi drejt Shkupit dhe ai drejt Prizrenit. Kufizohet me komunën e Prishtinës në veri dhe verilindje, të Fushë-Kosovës në veriperëndim, të Drenasit e të Malishevës në perëndim, të Shtimes në jugperëndim, të Ferizajt në jug dhe me komunën e Gjilanit dhe të Novobërdës në lindje. Në kuadër të kësaj komune me sipërfaqe prej 338 km² janë 62 vendbanime me 57,605 banorë, kurse dendësia e popullsisë është 170 b/km². Relievi është fushor, kodrinor dhe malor. Rreth gjysma e territorit të saj është fushor, me lartësi mbidetare deri në 600 m. Në lindje shtrihen malet e Zhegovcit, ndërkaq në perëndim masivi malor i Blinajës dhe i Goleshit. Në kuadër të ultësirës qendrore shtrihet numri më i madh i vendbanimeve, rrugëve dhe objekteve ekonomike. Nga viti 2007, me projektin e Ahtisarit për decentralizim, kësaj komune iu shkëputën 9 vendbanime me sipërfaqe prej 6,701 ha, të cilët kaluan nën administrimin e komunës së Graçanicës. Rrjedhjet ujore të kësaj komune i takojnë pellgut të Detit të Zi. Lumenjtë kryesorë janë:

Sitnica, Drenica, Janjeva dhe Klysyra, të cilët janë degë të Ibrit. Mbizotëron klima e mesme kontinentale, me ndryshime relative mes pjesës së ulët fushore që është më e butë dhe asaj kodrinore-malore pak më e ashpër. Temperatura mesatare është 10.5°C, maksimale 34°C në gusht dhe temperatura minimale -14°C në janar. Afërsia me Prishtinën (16 km), infrastruktura e mirë rrugore (autostrada drejt Shkupit, magjistralla drejt Prizrenit, nyja e rëndësishme hekurudhore dhe aeroporti ndërkombëtar) paraqesin kushte të volitshme për zhvillimin e bujqësisë, industrisë përpunuese, tregtisë dhe veprimtarive të tjera prodhuese dhe shërbyese. Pozita qendrore në Rrafshin e Kosovës dhe tokat pjellore në dy anët e Sitnicës mundësojnë zhvillimin intensiv të bujqësisë. Ndërsa në anën tjetër, shpella e mermerit në Gadime, uji termal në Bajicë, Parku i Blinajës dhe qyteza e vjetër e Janjevës paraqesin pika të rëndësishme për zhvillimin e turizmit. Sektor tjetër i rëndësishëm është industria nxjerrëse dhe përpunuese, siç janë miniera e Magurës, e pasur me magnezit dhe nikel, miniera e thëngjillit në Babush dhe industria e përpunimit të metaleve me ngjyra në Janjevë. (Përparim Gashi)

LIPOVICA Hoxhë (Jusuf Baftjari) (1883-1948). Veprimtar i lëvizjes antikomuniste. Lindi në Lipovicë (Gjilan). Luftëtar i shquar kundër vendosjes së pushtetit komunist në Kosovë. Bashkëpunëtor dhe bashkëluftëtarë i Idriz Hajrullahut – Mulla Idrizit. Njëri ndër komandantët e njësiteve vullnetare në mbrojtje të kufirit të Kosovës Lindore. Kundërshtoi okupimin fashist bullgar të një pjese të Rrethit të Gjilanit. Në maj 1941, H.Lipovica formoi njësitin e tij të rezistencës, në krye të të cilit qëndroi me armë në dorë në mbrojtje të jetës dhe pasurisë së popullatës shqiptare të kësaj ane nga keqpërdoruesit bullgarë dhe bashkëpunëtorët e tyre serbë. Pas kapitullimit të Bullgarisë fashiste (9 shtator 1944), konform urdhërësës së KQ të Lidhjes së Dytë të Prizrenit për mbrojtjen e kufirit nga sulmet e njësiteve partizane, H.Lipovica u caktua njëri ndër komandantët e zonave mbrojtëse të kufirit në vijën hekurudhore Kumanovë-Preshevë-Bujanoc. Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore dhe vendosjes së pushtetit komunist në Kosovë, H. L. së bashku me disa bashkëluftëtarë, për një kohë do të qëndrojnë të fshehur në malet e Karadakut. Kryesisht u

stehua në zonën e maleve të Pogragjës ku kishte shumë ndihmëtarë. Mori pjesë në Kongresin e Kopilakës më 15 e 16 gusht 1945, të organizuar nga Komiteti Qendror i LNDSH-së dhe Shtabi i Rezistencës. Pas aksioneve të shumta ushtarako-policore jugosllave, duke i parë të gjitha mundësitë e mbyllura për të vazhduar rezistencën, pas më se dy vjet qëndrimi në ilegalitet, më 20 shkurt të vitit 1947 dorëzohet me dy djemtë e tij dhe disa bashkëluftëtarë para organeve shtetërore. Burgoset dhe me aktgjykimin e datës 23 prill 1948, të Gjykatës së Qarkut në Gjilan, H. L. dënohet me vdekje, pushkatim dhe ekzekutohet. Djemtë e tij, Selimi u dënua me 17 vjet dhe Qazimi me 14 vjet burg të rëndë. (Naim Musliu)

LIQENET AKULLNAJORE. Liqene të krijuara nga veprimtaria erozive ose akumulative e akullnajave, të akullzimeve të periudhës së kuaternarit (pleistocenit), në rajonet postgla-



NJË LIQE AKULLNAJOR

ciale, në luginat e akullnajave në malet e larta. Liqenet akullnajore për nga mënyra dhe vendi i krijimit mund të jenë akumulative, të morenave dhe erozive, të cirqeve dhe luginave akullnajore. Liqenet e morenave janë lloj i liqeneve akullnajore akumulative, të cilët krijohen në basenet terminale të akullnajave, që nga ana e poshtme janë të muratosura nga materiali shkëmbor i morenave ballore, kështu që uji mbetet në to dhe shndërrohet në liqene. Janë të shpeshtë në malet e larta. Liqenet e cirqeve janë lloj i liqeneve akullnajore erozive. Janë karakteristike për rajonet malore të larta dhe krijohen në cirqet e akullnajave të dikurshme. Kanë formë rrethore ose thjerrëzore, me thellësi më të vogël se 10.0 m, zakonisht 1.5 m. Është karakteristike se në këto liqene nuk derdhen

rrjedha ujore, por as prej tyre nuk burojnë rrjedha uji. Ushqehen kryesisht nga të reshurat. Në Kosovë një numër i konsiderueshëm i liqeneve akullnajore të llojit të cirqeve paraqiten në Bjeshkët e Nemuna: liqenet e Gjeravicës, liqeni i Kuqishtës, liqeni i Drelajve etj. dhe në malet e Sharrit: liqeni i Livadhit dhe i Jazhincës. Liqeni i Livadhit gjendet në lartësi 2,173 m, ka formë elipse, me gjatësi 230 m, gjerësi 120 m dhe thellësi maksimale 7.3 m. Liqeni i Madh dhe i Vogël i Jazhincës gjenden në lartësi 2,140 m, përkatësisht 2,200 m, i dyti me formë të rrumbullakët, me diametër 35 m dhe thellësi 5.0 m. Ndërsa liqenet e Gjeravicës, Liqeni i Madh, gjendet në lartësi 2,320 m, me gjatësi 300 m dhe gjerësi 150 m, dhe Liqeni i Vogël, në lartësi 2,360 m, me formë të rrumbullakët dhe diametër 100 m. Liqeni i Kuqishtës ndodhet në lartësi 1,850 m, ka formë elipse, me gjatësi 220 m, kurse gjerësi 100 m. Liqeni i Drelajve ndodhet në lartësi 1,795 m, gjatësi 100 m, kurse gjerësi mesatare rreth 40 m. (Ruzhdi Pllana)

LIQENI I BADOVCIT (GRAÇANICËS). Liqen artificial në juglindje të Prishtinës. Është formuar me ndërtimin e pendës (lartësia 52 m) në rrjedhën e lumit të Graçankës, në afërsi të



LIQENI I BADOVCIT

fshatit Kishnicë. Vëllimi i tij është 27 milionë m³. Sipërfaqja e pasqyrës së ujit, kur liqeni mbushet plotësisht, është 175 ha. Ndërtimi i akumulimit u destinua për furnizim me ujë të pijes (qyteti i Prishtinës), ujitje (Rrafshi i Kosovës) dhe furnizim në flotacion të minierës (Kishnicë). Aktualisht, uji nga ky liqen shfrytëzohet për pije, për peshkim dhe për rekreacion. (Bashkim Kabashi)

LIQENI I BATLLAVËS. Liqen artificial në pjesën lindore të Kosovës. Akumulimi është ndërtuar në lumin Batllava, degë e majtë e Llapit. Është formuar me ndërtimin e një dige



LIQENI I BATLLAVËS

të lartë 46.5 m ndërmjet vendbanimeve Batllavë dhe Orlan (komuna e Podujevës). Vëllimi 35 milionë m³. Sipërfaqja e pasqyrës së ujit, kur liqeni është i mbushur përplot, është rreth 198 ha. Prurja mesatare e lumit të Batllavës është rreth 1.64 m³/s (50,46 milionë m³/vit), nga sipërfaqja ujëmbledhëse përkatëse prej 226 km². Me ujërat e këtij liqeni furnizohen me ujë të pijshëm qyteti i Prishtinës dhe i Podujevës me rrethina. Shfrytëzohet për peshkim dhe rekreacion. (Bashkim Kabashi)

LIQENI I BREZNËS. Liqen natyror në Opojë, afër fshatit Breznë, në rrezën lindore të Koritnikut. Ndryshe njihet si liqeni i Opojës. Liqeni është mbetje e liqenit të dikurshëm të Opojës (liqen relik). Është krijuar në karst. Ujërat e tij u tërhoqën përmes grykës së Lumës, nga fundi i pliocenit. Sot sipërfaqja e tij është mjaft e vogël. Shtrihet në lartësi mbidetare 940 m, me gjatësi 250 m dhe gjerësi 100 m. Ka sipërfaqe të ujëmbledhësit topografik prej 20 km². Hapësira përreth ndërtohet nga formacionet e gëlqerorëve. Ushqehet nga ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore. Mendohet se përmes kanaleve nëntokësore shkarkon një pjesë të ujit dhe ka lidhje me gurat karstike të Poslishtës dhe Vërmicës. (Selim Qevani)

LIQENI I FIERZËS. Liqen artificial. Është formuar në luginën e lumit Drin, në territorin e Shqipërisë, me ndërtimin e digës të lartë 177 m dhe të gjatë 380 m pranë fshatit Fierzë, rreth 20 km nga qyteti i Bajram Currit. Vëllimi

rreth 2,7 miliardë m³. Në të akumulohen ujërat e Drinit të Bardhë me prurje rreth 66.4 m³/s dhe të Drinit të Zi me prurje 116 m³/s. Sasitë e ujit në përgjithësi formohen (rrjedhin) nga sipërfaqet ujëmbledhëse (pellgjet) prej 14,173 km², në të cilat bëjnë pjesë ato të Drinit të Bardhë me 4,964 km² dhe të Drinit të Zi me 5,885 km². Liqeni i mbushur ka një sipërfaqe prej 7,250 ha, në të cilat janë përfshirë edhe 350 ha të territorit të Kosovës. Në pendën e liqenit është ndërtuar hidrocentrali i Fierzës (1971-1978), me kapacitet prej 500 MW, nga i cili prodhohen brenda vitit 1,800 GWh nga 4 gjeneratorët, të cilët vihen në lëvizje përmes 4 turbinave nga uji i këtij liqeni, me sasi prej 500 m³/s. Liqeni shfrytëzohet edhe për lundrim, rekreacion, peshkim etj. (Bashkim Kabashi)

LIQENI I LIVOÇIT. Liqen artificial në pjesën lindore të Kosovës, në afërsi të fshatit Livoç i Epërm (Gjilan). Është formuar me ndërtimin e pendës në shtratin e lumit Livoç. Sipërfaqja ujëmbledhëse prej 53.6 km² dhe prurja mesatare vjetore prej 0.25 m³/s ose 7,8 milionë m³ në vit. Liqeni ka një vëllim 1,5 milion m³, derisa mund të shfrytëzohet rreth 1,2 milion m³. Uji nga ky liqen artificial shërben për ujitje dhe peshkim. (Bashkim Kabashi)

LIQENI I PËRLEPNICËS. Liqen artificial në pjesën lindore të Kosovës. Akumulimi është formuar me ndërtimin e pendës në grykën më të ngushtë të këtij lumi në vitin 1982, afër fshatit Përlepnice, ndërsa pas dy vjetësh është ndërhyrë me injektimin e pjesës së majtë të tokës me perde injektuese (h=40 m). Akumulacioni i Përlepnicës furnizohet me ujë nga lumi Përlepnice, i cili ka një sipërfaqe ujëmbledhëse prej 62 km², me një prurje mesatare vjetore prej 0.5 m³/s ose 15.61 milionë m³/vit. Liqeni ka një vëllim prej 4.2 milionë m³, derisa mund shfrytëzohet 3.3 milionë m³. Uji nga ky akumulim kryesisht shërben për furnizim me ujë të qytetit të Gjilanit. (Bashkim Kabashi)

LIQENI I RADONIQIT. Liqen artificial në Rrafshin e Dukagjinit. Është krijuar me ndërtimin e pendës në shtratin e Përroit të Becit, duke përmbytur territorin e fshatit Radoniq. Me ndërtimin e digës (h=58 m) te kodra Boka e Vogël në veri të fshatit Zhdrellë është formuar hapësira për akumulim të ujërave të Përroi të



LIQENI I RADONIQIT

Becit (Përroi i Ratishtës) dhe ujërave nga Bistrica e Deçanit dhe e Lloçanit, përmes një kanali të gjatë (7,2 km). Uji nga Bistrica e Deçanit merret vetëm gjatë periudhës së lagësht (tetor-maj). Nga prurjet mesatare gjatë këtyre muajve formohen rreth 122 milionë m³ ujë. Liqeni ka një vëllim prej 113 milionë m³ bruto. Është ndërtuar për tri qëllime: ujitje të 21,000 ha të tokave bujqësore (me rreth 75% të ujit të akumuluar), ujë të pijes (18%) dhe të industrisë (rreth 7%). Ishte paraparë që ndërtimi i liqenit të bëhej në dy faza. U krye vetëm faza e parë, me të cilën u mundësua ujitja e rreth 10, 250 ha tokë bujqësore në komunat e Gjakovës, Rahovecit dhe Prizrenit dhe furnizimi me ujë të pijes i vendbanimeve të Gjakovës, Rahovecit, si dhe industrisë në këto komuna. (Bashkim Kabashi)

LIQENI I UJMANIT (GAZIVODËS). Liqen artificial në pjesën veriore të Kosovës. Liqeni u formua me akumulimin e ujit nga ndërtimi i digës në lumin Ibër. Gjendet në territorin e



PAMJE E LIQENIT TË UJMANIT

Kosovës dhe të Serbisë. Pjesa lindore e Kosovës, për shkak të kushteve klimatike, ka regjim jo

të përshtatshëm ujqor, gjë që u reflektua me mungesë të ujërave. Për plotësimin e nevojave të popullatës, industrisë (Trepçës, Ferronikelit, KEK-ut etj.) dhe bujqësisë, në fillim të viteve '60 të shek. XX u mor vendimi për ndërtimin e akumulimeve të ujërave vjetore të lumenjve, ndër to edhe të lumit Ibër (Hidrosistemi "Ibër-Lepenc"). Me këtë projekt parashihej akumulimi i ujërave i të dy lumenjve periferikë, Ibrit në veri dhe Lepencit në jug të Kosovës, i paraparë të ndërtohej në dy faza, duke i dhënë prioritet ndërtimit të objekteve të fazës së parë, sistemit të Ibrit. Faza e dytë, ajo e Lepencit, nuk u realizua. Për të akumuluar ujërat vjetore të lumit Ibër u ndërtua penda në shtratin e këtij lumi në Ujman (Gazivodë), në territorin e komunës së Zubin Potokut, 25 km në verilindje të Mitrovicës, duke krijuar akumulimin me vëllim prej 370 milionë m³, nga i cili menaxhohen të gjitha ujërat rrjedhëse të lumit Ibër prej 411,5 milionë m³, nga debiti mesatar i lumit prej 13.05 m³/s i formuar nga pellgu ujëmbledhës me sipërfaqe prej 1,060 km². Lartësia e pendës, kur liqeni është i mbushur, është 107.5 m dhe gjatësi 520 m, ndërsa gjatësia e liqenit të formuar me akumulimin e ujit është 22 km, me një sipërfaqe të pasqyrës së ujit prej 1,192 ha. Me vërshimin e ujërave, nga ky liqen janë përmbytur rreth 1,266 ha tokë. Nga liqeni i Ujmanit, përmes një tuneli prej 900 m, derdhet uji në Pridvoricë, në hidrocentralin e ndërtuar me fuqi prej 34 MW. Uji nga hidrocentrali derdhet në liqenin kompensues, i formuar me ndërtimin e një pende të lartë prej 10 m, gjatësi 330 m, nga e cila fillon kanali kryesor me gjatësi prej rreth 50 km, nga Pridvorica në Obiliq, me kapacitet fillestar prej 22 m³/s dhe përfundimtar prej 6.1 m³/s. Nga kanali Pridvoricë-Obiliq degëzohen kanalet e rendit të dytë me gjatësi të përgjithshme prej 112 km, të cilët çojnë ujin në tërë territorin e përfshirë në këtë hidrosistem: Vërbnicë-Mitrovicë (Trepçë) me gjatësi 2.8 km, kapacitet 3.5 m³/s; Mihaliq-Besi me gjatësi 14.4 km, kapacitet 3.6 m³/s; Besi-Graçankë me gjatësi 35.5 km, kapacitet 3.1 m³/s; Hamidi-Drenicë me gjatësi 12.2 km, kapacitet 3.5 m³/s; kanali i majtë i Drenicës me gjatësi prej 18.5 km, kapacitet 2.0 m³/s dhe kanali i djathtë i Drenicës me gjatësi 10 km, kapacitet 1.5 m³/s. Nga uji i liqenit të Ujmanit furnizohen me ujë të gjitha vendbanimet në të cilat shtrihen objektet e këtij sistemi (Zubin Potok, Mitrovicë, Vushtrri, Fushë-Kosovë,

Obiliq, Prishtinë, Skënderaj, Drenas, Komoran me rrethinat e tyre). Po ashtu, nga ky liqen është ndërtuar sistemi për ujitjen e 20,000 ha tokë bujqësore. Akumulimi i Ujmanit shmangu vërshimet e mundshme nga reshjet enorme të vitit 1979. (Bashkim Kabashi)

LIRIKA FAMILJARE. Është përcjellëse e jetës familjare, si lindja, martesja dhe vdekja. Këngët janë shumë të lashta. Nga tekstet rituale, si formula magjike, janë ruajtur vetëm ato që kishin të bënin me ceremoninë e varrimit, kurse ato për lindjen dhe martesën sot janë më të rralla. Këngët e lirikës familjare ndahen në tri grupe të mëdha, sipas riteve e dokeve, në: këngë për lindjen dhe ninulla, këngë dasmash dhe vaje e gjëmë. Ritet dhe këngët e lindjes kanë zanafillë nga periudha pagane. Ninullat ose këngët e djepit janë krijime të pasura me fantazi dhe shprehje imazhesh poetike për të ardhmen e lumtur të fëmijës. Këngët e dasmës janë më të shumtat në lirikën familjare dhe lidhen me fazat e zhvillimit të saj: me ritet e fejesës, me dasmë-kanagjegjin në shtëpinë e vajzës, me nisjen dhe mbylljes së dasmës dhe gostitë që bëheshin pas martesës. Krijimet e lirikës familjare dallohen për pasurinë origjinale të mjeteve shprehëse. Rol të rëndësishëm luan ritmi, organizimi i fjalës poetike dhe i tingujve të melodisë, si dhe refreni. Për lirikën familjare janë botuar disa vëllime, si nga Instituti i Kulturës Popullore në Tiranë, ashtu edhe nga Instituti Albanologjik i Prishtinës. (Leontina Musa)

LIRIKA POPULLORE. Gjinia më e përhapur e letërsisë gojore, në të cilën përfshihen ato krijime poetike që shprehin ndjenjat, shqetësimet, dëshirat e përjetimet intime të njeriut. Këngët lirike kanë formë të shkurtër me përmbajtje të ngjeshur dhe të përzgjedhur. Ajo përcjell jetën e njeriut në të gjitha fazat jetësore, duke u shtrirë në punët bujqësore, blegtorale, në jetën familjare, në lindje, dasma e pranë të vdekurit. Këngët lirike shquhen për ndjenja të thella intime, që përcaktojnë procese personale të gjendjeve shpirtërore. Sinkretizmi është njëra ndër karakteristikat themelore të lirikës. Vend të veçantë në poezinë lirike zënë këngët e punës, të cilat sot nuk e kanë ruajtur karakterin e tyre ritual. Edhe këngët e lirikës familjare kanë ruajtur mjaft elemente ritesh e besimesh të vjetra. Karakteristikë për këngët lirike të

dasmës për viset e Kosovës është përcjellja e tyre me def, dajre, e në disa vise edhe me tepsi. Lloj shumë i përhapur, si lirikë e mirëfilltë, janë këngët e dashurisë ose këngët e buta, siç i quan populli. Në to ruhen gjurmë konceptesh të mjedisëve dhe të epokave të ndryshme për ndjenjën e dashurisë dhe shquhen për fuqinë dhe larminë e mjeteve shprehëse. Pjesë e lirikës gojore janë edhe këngët e mërgimit (të kurbetit), të cilat i përshkon dhembja familjare e shoqërore, si dhe një sërë këngësh të tjera satirike. Një grup më vete janë edhe këngët e fëmijëve, këngë e motmotit etj. Për lirikën gojore janë botuar katër vëllime nga Instituti i Kulturës Popullore në Tiranë dhe pesë vëllime nga Instituti Albanologjik i Prishtinës. (Leontina Musa)

LITERATURA PEDAGOGJIKE. Tekste shkollore, monografi dhe vepra të veçanta profesionale-shkencore nga shkencat pedagogjike, të përkthyer ose origjinale shqipe, që përdoren në Kosovë. Fillet e kësaj literature lidhen me veprat pedagogjike të A. Xhuvanit dhe të autorëve të tjerë shqiptarë, të cilat i përdorën mësuesit kosovarë të arsimuar në Shqipëri për të vazhduar pas Luftës së Dytë Botërore, me botimin e veprave pedagogjike të përkthyer nga gjuha serbokroate. Ndër veprat e para të përkthyer ishin: "Didaktika elementare" (1951) e B. P. Jesipov, "Pedagogjia e përgjithshme me didaktikë" (1954) e R. Teodosiqit etj., për të vazhduar me përkthimin dhe botimin e veprave të tjera pedagogjike, fillimisht në Beograd, pastaj edhe në Prishtinë. Në vitin 1960 filluan të botohen edhe veprat e para pedagogjike origjinale nga autorë kosovarë. Jashar Rexhepagiqi botoi veprat: "Tema pedagogjike bashkëkohore" (1966), "Zhvillimi i arsimit dhe i sistemit shkollor të kombësisë shqiptare në territorin e Jugosllavisë së sotme deri në vitin 1918" (1970). Riza Brada botoi tekstin "Metodika e diturive të para nga matematika" (1972) etj. Universiteti i Prishtinës botoi edhe tekstet e para universitare nga fusha e pedagogjisë (Nijazi Zylfiu, "Didaktika I" dhe Hajrullah Koliqi "Andragogjia"). Krahas me themelimin dhe zhvillimin e degës së pedagogjisë të Fakultetit Filozofik, një numër pedagogësh u shquan edhe për hulumtime dhe botime të veçanta nga fusha të ndryshme të pedagogjisë. Në fushën e historisë së pedagogjisë bënë studime J. Rexhepagiqi, H.

Koliqi, A. Vokrri, B. Shatri, P. Berisha, A. Veseli etj.; në metodologji: J. Rexhepagiqi, B. Bekteshi; në didaktikë: Nj. Zylfiu, R. Brada, B. Bekteshi, I. Krasniqi, Xh. Murati, T. Zajazi, V. Nuredini, F. Osmani, H. Ismaili etj.; në metodikë të lëndëve të ndryshme: I. Dehiri, R. Brada, I. Krasniqi, B. Jaka, Sh. Maloku, R. Muja, A. Mustafa; në pedagogjinë familjare: A. Deva-Zuna, R. Brada; në pedagogjinë shkollore: R. Brada, I. Krasniqi, A. Deva-Zuna, J. Dervodeli etj.; në pedagogjinë parashkollore: A. Deva-Zuna, R. Brada, në pedagogjinë e fëmijëve me nevoja të veçanta: A. Devolli, N. Zabeli etj. Literatura pedagogjike në gjuhën shqipe në Kosovë u pasurua edhe me vepra të tjera të autorëve nga Kosova dhe nga Shqipëria. (Islam Krasniqi)

LIVI Tit (Titus Livius) (59 ose 69 p.e.s-17). Lindi në Patavium (Padova), në veri të Italisë. Ishte historiani më i shquar romak, i cili shkroi një histori monumentale për Romën dhe popullin romak, i përbërë nga 142 libra, prej të cilave vetëm 32 janë ruajtur ("Ab urbe Condita"). Livi ofroi të dhëna të rëndësishme mbi fushatat e Aleksandrit, Molos dhe Pirros në Itali, si dhe për luftërat iliro-romake. Ndër të tjera, të dhëna me shumë vlera janë ato që i jep në lidhje me marrëdhëniet dardano-maqedone dhe ato dardano-romake. (Emine Kalaja-Hajdari)

LIVOREKA Ramiz (1958-). Ekonomist, profesor universitar. Lindi në fshatin Ivajë, komuna e Kaçanikut. Shkollimin bazë e mori në vendlindje, ndërsa studimet universitare dhe pasuniversitare i kreu në Prishtinë. Në vitin 1981 filloi punën në ndërmarrrjen "Sharr" në Han të Elezit si referent dhe e përfundoi si drejtor financiar. Në tetor të vitit 1986 filloi punën asistent në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës, ku magjistroi dhe më pas doktoroi (1997). Përveç punës pedagogjike zhvilloi aktivitet të dëndur shkencor dhe profesional, me pjesëmarrje në konferenca të ndryshme dhe me botimin e punimeve shkencore për transicionin ekonomik, për rregullimin e tregut, për privatizimin, për mjedisin biznesor, si dhe për terminologjinë profesionale. Në periudhën 2002-2009



RAMIZ LIVOREKA

qëndroi në SHBA dhe Belgjikë për specializime dhe vizita studimore. Botoi tekste universitare “Kërkim marketingu” (2011) dhe “Parimet e mikroekonomisë” (2012). (Florentina Xhelili-Kransiqi)

LIZINGU FINANCIAR. Ligji në fuqi në Kosovë përkufizon lizingun financiar si dhënie e së drejtës së posedimit apo të përdorimit të një pasurie nga lizingdhënësi te lizingmarrësi në shkëmbim të një pagese periodike gjatë kohëzgjatjes së marrëveshjes së lizingut. Sipas ligjit në fuqi në Kosovë lizingu financiar mund t'i ofrojë lizingmarrësit të drejtën e blerjes së pasurisë që është objekt i lizingut, pas përfundimit të marrëveshjes së lizingut financiar. Ky ligj në Kosovë përcakton se në rastet e lizingut financiar, lizinglënësi përcakton pasurinë që është objekt i lizingut dhe furnizuesin. Për t'u konsideruar lizing financiar ligji në Kosovë kërkon që lizingdhënësi të fitojë të drejtën e posedimit dhe të përdorimit të pasurisë që është objekt i lizingut dhe që lizingu t'i përmbushë një ose më shumë nga këto kushte: e drejta në pasurinë, që është objekt i lizingut, kalon nga lizingdhënësi te lizingmarrësi në fund të kohëzgjatjes së lizingut; lizingu përmban një kusht të volitshëm për blerjen e pasurisë që është objekt lizingu, në kushte, të cilat janë më të favorshme se kushtet e tregut në kohën kur përfundon lizingu; kohëzgjatja e lizingut është për periudhën më të gjatë se 75% e qëndrueshmërisë ekonomike të pasurisë së dhënë në lizing apo vlera e pagesës së lizingut është më e madhe se 90% e vlerës së pasurisë që është dhënë në lizing në momentin e lidhjes së marrëveshjes së lizingut. Duke qenë se lizinglënësi mban të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e dhënë në lizing gjatë kohëzgjatjes së lizingut, ligji në fuqi në Kosovë përcakton se në rast të vonesës, lizingdhënësi mund të marrë në riposedim pasurinë e dhënë në lizing me një procedurë të përshpejtuar qoftë vetë (në qoftë se një veprim i tillë nuk është në kundërshtim me qetësinë publike), qoftë me urdhër të gjykatës apo me akt administrativ. (Dastid Pallaska)

LOCI Visar (1981-). Gazetar i sportit. Lindi në Pejë, ku përfundoi shkollimin fillor dhe të mesëm. Mbaroi studimet për gazetari në shkollën e gazetarisë “Faik Konica” në Prishtinë. Në vitin 2001 u punësua në të përditshmen “Koha ditore”. Si gazetar i sportit në “Kohën ditore” punoi deri në fund të vitit 2004, më

vonë ishte bashkëredaktor i rubrikës së sportit po në të njëjtën gazetë. Prej fillimit të vitit 2010 kreu detyrën e redaktorit të rubrikës së sportit në të përditshmen “Koha ditore”. Gjithashtu ka punuar te Radio-Peja dhe në gazetën sportive “Sport ekspres”. (Arsim Maxhera)

LOGORECI Ipeshkëv Ndre (Andrea) (?-1892). Të dhënat për veprimtarinë dhe jetën e tij janë të pakta. Dihet se u zgjodh ipeshkëv i Kishës Juliopolitane më 1887. Një vit më vonë, më 1888, iu besua edhe Argjipeshkvia e Shkupit. U shqua si prelat i përkushtuar për punë baritore të dioqezës së shkapërderdhur në një kohë krize dhe pushtimi. Në një letërqarkore, ai i fton të gjithë besimtarët që t'i falënderohen Zotit dhe Zojës së pamëkat që i kanë ruajtur nga fatkeqësitë dhe rreziqet e mëdha, duke mos theksuar për çka bëhej fjalë. U angazhua veçanërisht në rregullimin e shkollimit në dioqezë. Për këtë arsye, ai solli mësues të kualifikuar në Prizren, Gjakovë dhe vendet të tjera të Kosovës, ku kishte besimtarë katolikë. Vdiq në vitin 1892 në rezidencën e vet në Shkup. (Ndue Ukaj)

LOGORECI Mati (1867-1941). Rilindës, mësues dhe veprimtar i arsimit, Mësues i Popullit. Lindi në Shkodër, ku mori edhe mësimet e para dhe vijoi shkollën tregtare teknike. Arsimin e vazhdoi në Kolegjin Severian të Jezuitëve dhe iu dha mundësia të shkollonte në Monfalcone (Itali), ku vuri kontakte me arbëreshët dhe me rilindës të tjerë: De Radën, Dora d'Istrian, Seremben. Santorin etj. Në formimin e tij pati ndikim



MATI LOGORECI

edhe Ndre Mjeda dhe Andrea Logoreci. Bashkëpunoi edhe me intelektualë të tjerë, me Xhuvanin, Gurakuqin, Fishtën etj. Për qëllime studimore, M. Logoreci qëndroi në Itali, Francë, Austri etj., ku mori njohuri edhe për çështje të arsimit. Kontribut të veçantë dha në fushën e arsimit kombëtar. Në vitin 1889 hapi mësonjë-toren e parë kombëtare shqipe në Prizren dhe ishte mësuesi i parë i saj. Gjithashtu, ishte mësues në Shkup, në Shkodër dhe në Tiranë, ishte drejtor i Drejtorisë së Arsimit në Shkodër, që asokohe përfshinte edhe trevat e Kosovës, nën administrimin austro-hungarez, pastaj anëtar

i Këshillit të Epërm Arsimit të Shqipërisë, sekretar i përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit. Përveç arsimit, M. Logoreci u shqua edhe në veprimtari shoqërore e publicistike. Ishte anëtar i shoqërisë “Agimi” (Shkodër), pjesëmarrës në Kongresin e Manastirit (1908), kontribuoi në klubin “Gjuha shqipe” (Shkodër), mori pjesë në Kongresin e Lushnjës, drejtoi Komisionin Letraro etj. Është autor i disa veprave arsimore e publicistike: “Ndollina historijet t’motshme” (1911), “Plotësori i abetarit”, “Libri i mësuesit për përdorim të abetarit”, “Libër leximi për shkollat e mesme” (1920), “Komisia letrare shqype e Shkodrës”, “Histori e përgjithshme” (1926) etj. (Sabit Jaha)

LOGOTETI. Titull në Bizant dhe në disa nga vendet ballkanike. Në Bizant këtë titull e mbanin zyrtarë të lartë të financave dhe funksionarë të tjerë. Në kohën e Stefan Dushanit (1331-1355) titulli kaloi në Serbi, ndërsa personi që e mbante atë kishte postin e eprorit të kancelarisë së sundimitarit dhe të nëpunësve që punonin aty. Shumë studiues e barazojnë logotetin me “kancelarin” ose “sekretarin” e sundimitarit. Në kompetenca të tij hynin kryesisht të gjitha punët teknike lidhur me dhënien dhe të shkruarit e diplomave publike juridike. Përveç logotetit ekzistonte edhe logoteti i madh, i cili kishte nën kompetencat e tij një krahinë ose kishte pushtet mbi kishat, të lidhura me nënshtrimin e pronave tokësore dhe të drejtave të vjetra ose të reja të imunitetit etj. Përveç Rashës dhe territorit të sotëm të Kosovës, logotetë kishte edhe në Bosnjë dhe në Raguzë. Pas shpërbërjes së shtetit të Rashës (1355), posti i logotetit u praktikua në zyrat e princave feudalë, përfshirë këtu edhe zyrat e princave arbërorë në gjysmën e dytë të shek. XIV dhe në shek. XV. Logotetë ndonjëherë quheshin edhe dhjakë apo eprorë të zyrave të feudalëve. (Qerim Dalipi)

LOHAJ Muhib (1960-). Matematikan, profesor universiteti. Lindi në fshatin Mirash të Ferizajt, shkollën fillore e kreu në vendlindje, gjimnazin matematikor në Prishtinë (1979). U diplomua në departamentin e matematikës të Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore (FSHMN) të Universitetit të Prishtinës (UP) në vitin 1983. Kreu studimet pasuniversitare në FSHMN të Universitetit të Zagrebit (1986), ndërsa tezën e disertacionit të doktoratës e mbrojti në FSHMN të UP-së në vitin 2000. Në mënyrë suksesive është avancuar deri te titulli profesor

i rregullt (2011). Ligjëroi lëndë të ndryshme në studimet themelore e pasuniversitare në departamentin e matematikës dhe në atë të fizikës. Ka publikuar disa punime shkencore në revista ndërkombëtare e vendore dhe ka marrë pjesë me kumtesa në konferenca shkencore brenda dhe jashtë vendit. Ka qenë recensent në revistën “Zentrablatt-math” për publikimin e punimeve nga teoria e operatorëve (2095-2009). (Minir Efendija)


LOKAJ Andin (1976-). Gazetar-komentator i sportit. Lindi në Prishtinë. Shkollimin bazë dhe Akademinë e Arteve i kreu në Prishtinë. Është njëri prej komentatorëve të shquar sportivë të Kosovës dhe të hapësirës shqiptare. Në vitin 2001 krijoi redaksinë e sportit në Televizionin “Kohavision” (KTV), ku punoi për disa vjet. Në vitin 2007 punoi si redaktor i sportit në Televizionin “Klan Kosova”. Ndërkohë bashkëpunoi edhe me disa gazeta, si “Koha ditore”, “Kosova sport”, “Zëri” etj. Aktualisht punon në “Super sport Kosova”, në Kanalën e mirënjohur të medias “Digitalb”, si komentator i ndeshjeve të Ligës së Anglisë, Italisë dhe të Superligës së Kosovës. (Besim Kajtazi)

LOKAJ Asim (1951-2001). Skulptor. Lindi në Lëbushë të Deçanit. Kreu Akademinë e Arteve Figurative, dega e skulpturës, në Prishtinë (1997). Mori pjesë në disa ekspozita kolektive ndërkombëtare. Prej vitit 1996 ishte anëtar i Shoqatës së Artistëve Figurativë të Kosovës dhe i Shoqatës Mbarëkombëtare të Artistëve Figurativë në Tiranë, si dhe i Asociacionit Ndërkombëtar të Arteve Plastikë me seli në Bruksel. Punoi si skenograf në Radiotelevizionin e Prishtinës. Në qershor të vitit 1988 u inkuadrua në radhët e UÇK-së. La pas një numër veprash skulpturale, nga të cilat veçohen: “Duart-besëlidhja”, bustet e Ismail Qemalit, Nënës Terezë, vëllezërit Frashëri (Deçan), Migjeni, Bajram Currit etj. Bashkë me të vëllanë, Xhavit Lokajn, realizoi shtatoren e Naim Frashërit në Tetovë, si dhe disa relieve, nga të cilët shquhet ai në Qendrën Kulturore Gjermane në Pejë. Skulpturat e tij shquhen për nga shprehja realiste e ekspresive me primesa moderne. (Luan Mulliqi)

LOKAJ Nimon (1941-). Piktur. Lindi në Pobergjë të Deçanit. Shkollimin fillor e kreu në vendlindje dhe Pejë, ku kreu edhe Shkollën e

Mesme të Artit. Studimet i kreu në Akademinë e Arteve Figurative (drejtimin e pikturës) në Beograd (1969). Pas studimeve punoi mësim dhënës i artit figurativ në Gjimnazin "Vëllazërit Frashëri" në Deçan deri në pensionim më 2006. Si anëtar i Shoqatës së Artistëve Figurativë të Kosovës ka marrë pjesë në shumë ekspozita të përbashkëta brenda dhe jashtë vendit. Ka çelë disa ekspozita personale, si në Tivar (1970), Prishtinë (1970, 1974, 1990), Podgoricë (1973), Ferizaj (1976), Tuzëll (1981), në Njuburgh dhe Nju-Jork (1999). Gjatë luftës së viteve 1998/99 nga policia dhe ushtria serbe iu dogjën qindra punime, vepra arti. Vizatimet e tij i shquan vija poetike e thurur me ndjesi, akuarelet i karakterizon impresionin e ngjyrave tonale me kalime te lehta, ndërsa pikturat me ngjyra vaji i veçon dritëhija me shprehje poetilike. Ka fituar një sërë çmimesh dhe mirënjohjesh brenda dhe jashtë vendit. (Rexhep Goçi)

LOKAJ Selman (1944-). Aktor. Lindi në Pobergjë të Deçanit. Shkollën e mesme e kreu në Prizren, ndërsa për aktrim studioi në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prishtinë. Në Teatrin



SELMAN LOKAJ

Popullor Krahinor të Kosovës ka punuar nga viti 1967. Ka marrë pjesë në realizimin e shumicës së veprave që janë realizuar në skenën e këtij teatri, duke filluar nga veprat antike, ato të letërsisë botërore dhe atyre origjinale. Ka marrë pjesë në realizimin e filmave artistikë të metrazhit të gjatë dhe të metrazhit të shkurtër. Aktrimin e tij e karakterizon diksioni i pastër dhe lëvizjet e sinkronizuara skenike. Mori pjesë në këto shfaqje: Edipi mbret, "Nata e fundit në Goli Otok", "Beselam pse më flijojnë", "Gof", "Engjëlli i vdekjes", "Orestia", "Shtettrëthimi", "Burgu i hapur", "Laokonti", "Dosja H", "Nirvana" etj. Ka luajtur edhe në filmat: "Kthimi" të K. Avdylit, "Falja e gjakut" të J. Matson-it, "Lufta mbaroi" të M. Panov-it dhe në dramën televizive "Rropullari" të B. Musliut. (Selman Jusufi)

LOKAJ Sulejman (1933-). Aktor, piktor. Lindi në Lëbushë të Deçanit. Shkollën fillore e kreu në Isniq, ndërsa në Pejë mbaroi Shkollën e Mesme të Artit. Studimet për art figurativ i kreu më 1976 në Shkollën e Lartë Pedagogjike



SULEJMAN LOKAJ

në Prishtinë. Për një kohë punoi si arsimtar i artit figurativ në Isniq, Deçan dhe Istog. Në teatër fillimisht punoi si aktor dhe regjisor amator i disa shfaqjeve, në të cilat shpesh e bënte edhe dramatizimin dhe skenografinë. Më 1964 u punësua si aktor në Teatrin e Kombësive (Drama Shqipe) në Shkup ku deri më 1976 luajti një sërë rolesh në shfaqje të ndryshme, nga të cilat veçohen: "Nita", "Karnalet e Korçës", "Buçitje malesh", "Dielli i mbrëmjes dhe i mëngjesit", "Armiku i popullit", "Pylli", "Fundrrinat", "Mikroborgjezët" etj. Nga viti 1976 punoi si aktor në Teatrin Popullor të Gjakovës, ku gjithashtu luajti një sërë rolesh në shfaqje të ndryshme: "Fisheku në pajë", "I paepuri", "Babai im kullak socialist", "Rënia e madhe", "Intrigë e dashuri", "Njeriu me top", "Pirroja", "Beselam pse më flijojnë", "Ezopi", "Epoka para gjyqit", "Moisiu në Unazën e Inlandit", Urithi "Dinosauri", "Korali Lensdaun thotë jo" etj. Luajti gjithashtu edhe në disa filma të metrazhit të gjatë ("Kur pranvera vonohet", "Njeriu prej dheu", "Rojet e mjegullës" dhe "Proka"), në disa filma televizivë ("Era dhe Lisi", "Kulla", "Migjeni" etj.), si dhe në disa filma të metrazhit të shkurtër. Në cilësinë e piktorit ka hapur edhe disa ekspozita personale. Merret edhe me shkrime letrare dhe publicistike. U nderua me çmimin kombëtar për vepër jetësore (2012) nga Ministria e Kulturës e Kosovës. (Naime Beqiraj)

LOKAJ Xhavit (1951-). Skulptor. Lindi në Lëbushë, komuna e Deçanit. Kreu Akademinë e Arteve, dega e skulpturës, në Prishtinë (1997). Është anëtar i Shoqatës së Artistëve Figurativë të Kosovës nga viti 1997. Punoi në Institutin për Mbrojtje të Trashëgimisë në Prishtinë. Mori pjesë në ekspozita kolektive brenda dhe jashtë vendit dhe, bashkë me vëllanë, Asim Lokajn, ka realizuar shtatoren e Naim Frashërit në Tetovë. Kryesisht është marrë me trajtimin e portreteve të rilindësve dhe të atdhetarëve të shquar, duke i paraqitur në frymë reale deri ekspresive. (Luan Mulliqi)

LOKALITETI ANTIK I DËRSNIKUT. Vëllanë e antikës. Ngrihet në një tarracë lumore të fshatit Dërsnik, në anën e majtë të rrugës



KËRKIMET ARKEOLOGJIKE NË LOKALITETIN ANTIK TË DËRSNIKUT


Klinë-Dërsnik të luginës fushore midis lumenjve Drini i Bardhë dhe Klina. Quhet me toponimet Gradinë dhe Nërvadë. Falë gjetjeve të rastit të mbishkrimeve antike, është shënuar si lokalitet i rëndësishëm nga E. Çershkov në fillim të shek. XX. Në Gradinë u zhvilluan kërkime arkeologjike gjatë viteve 2012-2015 (Instituti Arkeologjik i Kosovës) dhe u zbuluan gjurmët e pallatit luksoz të shek. III-IV. Pallati ka planimetri drejtkëndore, me dimensione 200 x 200 m (40,000 m²). Është zbuluar gati në tërësi muri lindor rrethues i tij me dy kulla, pastaj bazilika civile e pallatit dhe kompleksi i banesave në anën perëndimore. Muri rrethues lindor, i ndërtuar në teknikë opus incertum dhe opus mixtum, është i gjerë 3.70 m. Kullat gjenden në anën e jashtme të murit rrethues dhe kanë formë rrethore (diametri 10 m). Bazilika (26 x 14 m) ka dysheme të shtruar me mozaik me motive gjeometrike, të krijuar përmes zajeve shumëngjyrëshe (rreth 500 m²). Në perëndim të pallatit ndodhet kompleksi i banesave luksoze, të shtruara me dysheme teknikash të llojllojshme dhe të pajisura më hipokaustikë. Brenda pallatit janë zbuluar gjetje të shumta arkeologjike, ku veçohen dy torzo mermeri të hyjneshës Afërdita dhe katër stela dardane mermeri me mbishkrime, në përdorim dytësor. Në njërin prej stelave është skalitur mbishkrimi i emrit të një dekurioni të municipit të Ulpianës, që dëshmon se vendbanimi i Dërsnikut i ka takuar territorit të municipit të Ulpianës. Në toponimin Nërvadë gjatë punimeve bujqësore janë zbuluar monumente mermeri, stela, altarë dhe fragmente të arkitekturës. (Haxhi Mehmetaj)

LOKALITETI PARAHISTORIK I BËRNICËS SË POSHTME. Shih: KULTURA E BËRNICËS.

LOKALITETI PARAHISTORIK I GLLAREVËS. Lokalitet arkeologjik i epokës së bronzit të mesëm dhe epokës së hershme të hekurit. Përbëhet nga varrezat Gllareva I dhe Gllareva II. Gllareva I gjendet në fshatin Rixhevë afër Klinës dhe në të janë zbuluar 39 varre me konstrukcion gurësh. Gllareva II gjendet te Kërshina, midis Gllarevës dhe Dobërdolit dhe në të janë zbuluar 9 varre me konstrukcione me pllaka guri dhe dysheme prej guralecësh. Varrimi në të dy varrezat është bërë me trupvënie dhe djegie. Varret me djegie e kanë hirin të vendosur në urna. Inventari i varreve përbën qeramikë, stoli metalike, kama, heshta bronzi, gjilpëra, kapëse dhe shpata të tipit mikenas. Shpatat paraqesin rëndësi edhe për lidhjet e rajonit me qytetërimin e Mikenës. Periudha e bronzit në të lidhet me procesin e formimit të popujve të vjetër ballkanikë, kulturës dhe etnogjenezës së tyre. Gërmimet arkeologjike u realizuan nga Muzeu i Kosovës (1986, 1991, 1992). (Kemajl Luci)

LONGARI. Mbret i Dardanisë, i pari i njohur me emër. Mbretërit e mëhershëm janë shënuar vetëm si "mbret" (gr. basileos, lat. rex). Njëri prej tyre i ofroi ndihmë mbretit të Maqedonisë, Ptoleme Keraunit, në luftë kundër galëve (279 p.e.r.). Longari sundoi Dardaninë pas mesit të shek. III p.e.r. dhe pastaj u trashëgua nga djali i tij Bato. Në kohën e sundimit të tij maqedonët u dëbuan nga Peonia, u çlirua Bylazora (Velesi), qytet me rëndësi strategjike dhe u mor nën sundim një pjesë e madhe e Peonisë (219 p.e.r.). Dardania u fuqizua shumë gjatë sundimit të Longarit, duke rrezikuar edhe shtetin maqedon edhe atë ilir, në krye me Teutën. Madje, në vitin 216 p.e.r. e detyroi Filipin V që t'i ndërpriste luftimet me romakët dhe ta mbronte Maqedoninë. Mbretërimin e tij e konfirmon edhe autori antik Tit Livi. (Emine Kalaja-Hajdari)

LORD Albert (1912-1991). Profesor i Universitetit të Harvardit, studiues dhe mbledhës i folklorit shqiptar, sidomos i këngëve shqiptare të kreshnikëve. Vepra e tij kryesore është "Këngëtarja e Tales" (*The Singer of Tales*), e botuar më 1960 në Kembrixh. Është autor



ALBERT LORD

i punimeve të rëndësishme studimore nga fusha e epikës. Bashkë me Millmen Perrin (Milman Parry), homerolog dhe mbledhës i folklorit të disa popujve të Ballkanit, mblodhën këngë shqipe gjatë viteve 1934-1935.

Është me rëndësi puna e tyre me lahutarët shqiptarë dygjuhësorë në sanxhakun e Pazarit. Këngët e tyre (mbi 12 mijë tekste) gjenden në Bibliotekën Uajdener të Harvardit (Widener Library) dhe ruhen me emrin “Koleksioni i letërsisë gojore i M. Perit” (*The Milman Parry Collection of Oral Literature*). Një pjesë e tyre janë botuar anglisht dhe boshnjakisht në Kembrixh (1953, 1974), në Beograd (1953) e në Sarajevë (1987). Në Harvard quhet koleksioni më i madh në botë i epikës heroike të sllavëve të jugut. Në kuadër të tij është edhe “Koleksioni shqip i Albert Lordit”, që ka rreth 23 mijë vargje, kryesisht nga Malësia e Shqipërisë së Veriut. Aty ka edhe lahutarë nga rrethina e Pejës, Rugova dhe Plava e Gucia. Shumica janë këngë të kreshnikëve. Këto këngë nuk janë botuar ende. (Zymer U. Neziri)

LOSHI Ali (1923-1996). Pemëtar. Lindi në Gjakovë, shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Prishtinë, ndërsa studimet në Fakultetin e Bujqësisë të Universitetit të Beogradit (1952). Qe i burgosur dhe i internuar nga nazistët (1944) dhe i burgosur politik, i internuar në Goli Otok (1950). U punësua në kombinatin bujqësor “Ereniku” në Gjakovë. Punoi në projekte për ngritjen e plantacioneve të para të vreshtave në Gjakovë e Bec dhe të atyre të pemëve në Hereq e Piskotë. Dha mësim në shkollën e mesme të amvisërisë në Gjakovë. U mor edhe me përkthimin e teksteve shkollore profesionale nga lëmi i vreshtarisë dhe pemëtarisë. (Agim Zajmi)

LOSHI Kamer (1886-1925). Luftëtar për çlirimin e Kosovës. Lindi në Padalishtë të Istogut. Që në moshën 16-vjeçare e nisi luftën kundër pushtuesve turq dhe e vazhdoi kundër atyre serbë e malazezë pas vitit 1912. Me pushtimin e Kosovës nga Serbia dhe Mali i Zi më 1912, familja e tij u dërgua në kampin e improvizuar në Runik të Skënderajt, i

njohur si Lloqi i Runikut. K. Loshi i shpëton internimit dhe u arratis në mal. Po atë vit në mal iu bashkuan edhe tre vëllezërit e tij, si dhe një numër bashkëluftëtarësh, me të cilët formoi çetën për të luftuar Serbinë dhe më pas edhe Austro-Hungarinë. Me çetën e tij mori pjesë në më shumë se 60 përballje luftarake kundër ushtrisë dhe xhandarmërisë serbe (1912-1925), likuidoi shumë prijës çetnikë, si Berdo Shupovakun etj. Mori pjesë edhe në shuarjen e “Republikës së Gjon Marka Gjonit” (1921) dhe në Revolucionin demokratik në Shqipëri (1924). K. Loshi u rrethua nga forcat serbe në fshatin Balicë dhe, pasi iu vranë shokët dhe vetë ishte plagosur, bëri vetëvrasje më 14 mars 1925. (Liman Rushiti)

LOXHA Afrim (1946-1999). Veprimtar i çështjes kombëtare, organizator i demonstratave të vitit 1968. Lindi në Pejë. Shkollën fillore e kreu në vendlindje. Në vitin 1961 familja e tij u shpërngul në Prishtinë. Po këtë vit u regjistrua në Shkollën e Mesme Teknike në Prishtinë. Në vjeshtë të vitit 1968 mori pjesë në organizimin e demonstratave të studentëve dhe të rinisë shkollore në Kosovë. Ishte ndër të parët nga organizatorët e demonstratave që u burgos. Në prill të vitit 1969 u dënua me 3 vjet burgim. Pasi u lirua nga burgu, vazhdoi studimet në Fakultetin Teknik të Universitetit të Prishtinës. Pas përfundimit të studimeve punoi si inxhinier në Ndërmarrjen “Elektrokosova” në Obiliq. Mori pjesë aktive edhe në zhvillimet e viteve ‘90, për çka u gjend në shënjestër të policisë serbe. Në periudhën e luftës ishte aktiv në mbledhjen e ndihmave për nevojat e luftës dhe të popullsisë civile. Pas fillimit të bombardimeve të NATO-s në vitin 1999, në lagjen “Dardania” në Prishtinë u vra nga forcat paramilitare serbe. (Luan Tetaj)


LOXHA Nuredin (1935-1992). Skenograf, kostumograf, dramaturg. Lindi në Pejë, ku mbaroi shkollën fillore dhe të mesme, studimet universitare i kreu në Akademinë e Arteve Aplikative në Beograd. Në vitin 1964 u angazhua si skenograf profesionist në Teatrin Popullor Krahinor (TPK) dhe, prej asaj kohe, për gati 30 vjet ishte autor i shumicës së skenografive dhe kostumografive të shfaqjeve të realizuara në këtë teatër. Skenografitë e tij më të realizuara ishin në shfaqjet: “Tartufi”, “Othello”, “Po shkoj për gjah”, “Duart e ndyta”, “Edipi Mbret”,



NUREDIN LOXHA

“Perkolgjinajt”, “Makbethi”, “Sfinga e gjallë”, “Emigrantët”, “Besa e madhe” etj. Kultivoi artin e ndërhyrjeve dhe të përshtatjeve në pajtim me kulturën ambientale të hapësirës, duke gërshtetuar konvencionalen me bashkëkohoren dhe u shqua me shmangien e skematizmit, veprime që pikasen në skenografitë e shfaqjeve: “Tri ditët e kiametit”, “Revizori”, “Mosha e bardhë”, “Trungu Ili”, “Hamleti”, “Genci” etj. Ndërkaq, për stilin modern në perceptimin dhe konceptimin skenografik u shqua me kreacionet e tij në shfaqjet: “Shtetrrëthimi”, “Verbimi i Samsonit”, “Varri i qyqes”, “Emira”, “Vdekja më vjen prej syve të tillë” etj. Po ashtu ishte skenograf për filmat “Kur pranvera vonohet”, “Përroi vërshtues” dhe “Njeriu prej dheu”. Punoi edhe kostumet për filmin “Uka i Bjeshkëve të Nemuna”. Është edhe autor dramash: “Dan Shejtani”, që u inskenua në TPK në vitin 1979, pastaj “Të vdekur të pavarrosur” dhe “Vajaku”, të botuar pas vdekjes (2002). Për punën e suksesshme në skenografi dhe kostumografi mori disa çmime në Kosovë dhe në ish-Jugosllavi. (Besim Rexhaj)

LOXHA Ragip (1916-1989). Aktor. Lindi në Pejë, ku përfundoi shkollën fillore dhe të mesme, ndërsa Shkollën e Lartë Juridike e kreu në Beograd. Ishte njëri ndër doajenët dhe aktorët emblematikë të Teatrit Popullor Krahinor (TPK), ku filloi karrierën që nga viti 1960. Disa nga shfaqjet më të rëndësishme, në të cilat ai luajti janë:



RAGIP LOXHA

“Lavirja e denjë për respekt”, “I ndjeri”, “Dredhitë e Shaptukut”, “Tri ditët e kiametit”, “Perkolgjinajt”, “Spiuni” etj. Luajti edhe në disa filma të metrazhit të gjatë. Për rolet në teatër u vlerësua me disa çmime: Me rolin e Cuk Sokolit në shfaqjen “Fosilet” e Azem Shkrelit dhe në regji të Aleksandër Kovaqeviqit (TPK, 1968) fitoi Shpërblimin e 1 Majit, kurse për rolin e Qazim Mulletit në shfaqjen “Prefekti” të Besim Levonjës dhe me regji të Dhimitër Pecanit (TPK, 1978), që konsiderohet si roli i tij jetësor, u laureua me Shpërblimin e Dhjetorit. (Arian Krasniqi)

LOXHA Zeki (1941-). Inxhinier i teknologjisë. Lindi në Pejë, ku kreu shkollën fillore dhe gjimnazin. Kreu studimet në Fakultetin e Teknologjisë të Universitetit të Sarajevës (1965). Studimet pasuniversitare i kreu në Universitetin e Zagrebit. Si inxhinier i teknologjisë inorganike filloi punë në Fabrikën e Akumulatorëve në Mitrovicë. Krahas punës në fabrikë, ishte edhe mësimdhënës në Shkollën e Lartë Teknike në Mitrovicë dhe në Fakultetin Xehetar-Metalurgjik të Universitetit të Prishtinës (1974-79) për lëndët teknologjia inorganike dhe burimet kimike të energjisë. Në periudha të ndryshme ushtroi edhe funksione të tjera: drejtor teknik i Fabrikës së Akumulatorëve, njëri nga udhëheqësit e Institutit “Trepça” etj. Ishte drejtues në disa fusha profesionale shkencore të prodhimit dhe të perfeksionimit teknologjik të akumulatorëve. Kreu një varg specializimesh në botën e jashtme në lëmin e burimeve kimike të energjisë, si në Gjermani, SHBA, Spanjë, Holandë, Bullgari etj. dhe mori pjesë në shumë simpoziume dhe konferenca profesionale dhe shkencore. (Minir Dushi)

LUBIZHDA E PRIZRENIT. Fshat në komunën e Prizrenit, 4 km në verilindje të tij, shtrihet rrezë Malit të Sharrit, në lartësi mbidetare 470 m. Është vendbanim i tipit të dendur, me sipërfaqe 12.5 km². Pjesa dërrmuese e territorit të fshatit është e mbuluar me pyje, ara dhe livadhe. Në aspektin fizionomik është bashkuar me zonën periurbane të Prizrenit dhe paraqet një paralagje të qytetit. Si vendbanim me emrin Lubinje është regjistruar në defterin e sanxhakut të Prizrenit të vitit 1530. Në Lubizhdë u vendosën 14 familje kolonësh serbë me 70 anëtarë dhe formuan lagjen e quajtur Lubizhda e Re. Një numër i konsiderueshëm i banorëve emigroi brenda dhe jashtë Kosovës. Megjithatë numri i popullsisë së fshatit shënoi rritje të vazhdueshme brenda periudhës 1948-2011. Në vitin 2011 Lubizhda kishte 5982 banorë, ndaj 743 banorëve sa kishte në vitin 1948. Është bashkësi lokale dhe zhvillohet si qendër e pavarur rurale. Popullsia merret me bujqësi ekstensive (lavërtari dhe pemëtari), blegtori, tregti, ndërtimtari etj. Ka shkollën 9-vjeçare, shtëpinë e kulturës, stacionin shëndetësor, dyqanet tregtare etj. (Hasim Kryeziu)

LUBOTENI. Mal në skajin verilindor të Maleve të Sharrit, shtrihet në territorin e



MAJA E LUBOTENIT

Kosovës dhe të Maqedonisë. Pjesa e ngritur e Lubotenit në plan ka një formë të trekëndëshit me bazë në Maqedoni, ndërsa vertikalisht paraqitet në formë të një koni të thiktë. Maja më e lartë është 2,498 m. Në përbërjen gjeologjike të Lubotenit marrin pjesë gëlqerorët e mermerizuar, granitoidët e metamorfizuara e rreshtet kristallore të paleozoikut, mermerët e dolomitët e triasikut, serpentinitet dhe depozitimet glaciale të kuaternarit. Është e zhvilluar morfologjia glaciale dhe e nivacionit, e përfaqësuar me bedeme të morenave, cirqe, “trogje”, lugina fluvioglaciale, “lumë gurësh” (“rrjedha të gurëve”) etj. Karakterizohet me klimë malore, me temperaturë mesatare vjetore rreth 4°C, me të reshura të shumta të borës dhe shiut (1200 mm/vit) dhe me paraqitje të ortekëve të borës. Është pjesë e Parkut Nacional të Sharrit në Kosovë. (Vahdet Pruthi)

LUBOTENI Gani (1927-2011). Profesor universiteti, hartues i teksteve shkollore, leksikograf, përkthyes. Lindi në Prizren. Kreu shkollën fillore në vendlindje, ndërsa Shkollën Normale në Gjakovë. U diplomua në Fakultetin e Filologjisë në Beograd, në degën e albanologjisë (1953). Mbrojti tezën e doktoratës në Zagreb më 1980. Punoi si mësues në Prizren dhe në Prishtinë. Në Fakultetin Filozofik të Prishtinës filloi të jepte mësim që në vitin 1960, si ligjërues dhe profesor i teorisë së letërsisë dhe i metodikës së gjuhës dhe letërsisë. Ishte bashkëpunëtor i Institutit Albanologjik

të Prishtinës, i organeve arsimore, i institucioneve shkencore dhe i redaksive të ndryshme dhe dekan i Fakultetit të Filologjisë. Ishte edhe mbledhës i folklorit shqiptar. Është autori i tekstit “Teoria e letërsisë” (1964) dhe i disa teksteve shkollore nga fusha gjuhës dhe e letërsisë shqipe, të botuara që nga viti 1959 dhe prapa. Është bashkautor i Fjalorit serbokroatisht-shqip dhe shqip-serbokroatisht (1974). Dha kontribut të çmuar në fushën e arsimit, të kulturës dhe të shkencave filologjike. (Isak Shema)

LUBOTENI Gazmend (1957-). Ekonomist, profesor universiteti. Lindi në Prizren, arsimimin bazë e mori në Prishtinë, ku kreu edhe Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës (1980). Më pas kreu

GAZMEND
LUBOTENI

studimet pasuniversitare, ndërsa në vitin 1996 mbrojti tezën e doktoratës: “Menaxhmenti financiar i bankave afariste në periudhën e çrregullimit të viteve ‘90”.

Punoi në Bankën e Lubjanës në Prishtinë. Që

nga viti 1985 punon në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës. Ishte anëtar i Bordit Drejtues të Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës, paraardhësit të Bankës Qendrore të Kosovës (1999-2006), kryetar i Bordit Drejtues të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (2007-2012) etj. Botoi tre tekste universitare: “Bankat dhe afarizmi bankar”, “Menaxhmenti bankar” dhe “Financat e korporatave”, si dhe një numër punimesh shkencore-profesionale. Mori pjesë në programe të ndryshme të specializimit dhe të ngritjes profesionale, kryesisht në SHBA, ku u mor me hulumtime të tregjeve dhe të institucioneve financiare në kushtet e çrregullimit. Që nga viti 2006 është anëtar i Këshillit për Aftësinë Afariste në Europë (European Business Competence License-EBCL) me seli në Paderborn, Gjermani. (Drita Kongjeli)

LUCAJ Gjon (1887-1978). Veteran i arsimit, atdhetar. Lindi në Shkodër. Shkollën fillore e kreu në Shkodër dhe në Podgoricë, ku kreu edhe tri klasë të gjimnazit të ulët. Që në moshë të re filloi veprimtarinë patriotike, për çka u dënua dhe vuajti shumë vjet burg. Në vitin shkollor 1917/18 për herë të parë çeli shkollën fillore shqipe në Dinoshë të Tuzit, në Mal të

Zi. Dha mësim edhe në shkollën fillore shqipe në Arzë (Hot), kurse në periudhën 1946-1952 ishte mësues në Triesh. (Palokë Berisha)

LUCAJ Lucë (1916-2001). Veprimtar i arsimit. Lindi në fshatin Stjepoh të Trieshit. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, gjimnazin e ulët në Podgoricë, ndërsa normalen në Cetinë. Në vitin 1948 kreu edhe Shkollën e Lartë Pedagogjike në Sarajevë. Punën mësimore e filloi në vendlindje, në vitin shkollor 1941/42, pastaj edhe në shkollën fillore në Ljare, në gjimnazin e ulët, përkatësisht në shkollën tetëvjeçare në Ulqin, pastaj në Tuz dhe në Prishtinë. Ndërkohë ishte edhe inspektor i shkollave shqipe në Mal të Zi, një vit edhe gazetar. Në periudhën 1962-1983 ishte këshilltar pedagogjik për shkollat me mësim në gjuhën shqipe në Mal të Zi. Shkroi edhe disa artikuj profesionalë, si dhe monografinë “Triepshi ndërmjet Malësisë dhe Kuçit” (2001). (Palokë Berisha)


LUCI Kemajl (1951-). Arkeolog. Lindi në Shabac, ndërsa arsimin fillor dhe të mesëm i kreu në Shkup. Diplomoi në Fakultetin e Filozofisë, katedra e arkeologjisë në Universitetin e Beogradit (1977). Në vitin 1977 u punësua si kustos në Muzeun e Kosovës. Ka pasur disa poste udhëheqëse në Muzeun e Kosovës, si udhëheqës i sektorit të arkeologjisë, zëvendës drejtor (2013-2015) dhe drejtor i Muzeut të Kosovës (1999-2001). Ishte udhëheqës i gërmimeve arkeologjike në shumë lokalitete të Kosovës gjatë viteve 1977-2014 dhe pjesëmarrës në kongrese dhe simpoziume shkencore dhe profesionale brenda dhe jashtë vendit. Bashkautor në librat: “Harta arkeologjike e Kosovës” I (2006) dhe “Harta arkeologjike e Kosovës” II (2013), “Katalogu arkeologjik i Kosovës” (2013), “Thesari Arkeologjik i Kosovës” (1999), si dhe autor i një numër studimesh shkencore të botuara në organe dhe revista të ndryshme, brenda dhe jashtë vendit. Realizoi një sërë ekspozitash arkeologjike të organizuara nga Muzeu i Kosovës dhe të tjerë. Është anëtar i jashtëm i Institutit Arkeologjik të Gjermanisë (DAI) dhe anëtar i Shoqatës së Arkeologëve të Europës (EAA). (Premtim Alaj)

LUCI Nita (1977-). Antropologe. Shkollën fillore dhe të mesme i mbaroi në Prishtinë, studimet në Universitetin e Bllagoevgradit në Bullgari, studimet e magistraturës dhe doktoratën

për antropologji në Universitetin e Miçigenit, SHBA. Doktoroi në temën: “Kërkesa e pavarësisë: bërja e kombit, kujtesa dhe burrëria në Kosovë”. Puna e saj kërkimore është e përqendruar në tema të gjinisë dhe burrërisë, mbi shtetin, post-socializmin, nacionalizmin, artin bashkëkohor, intervenimet ushtarake, kujtesën dhe dhunën. Ligjeron temat nga antropologjia, sociologjia dhe arti bashkëkohor. Gjithashtu është e angazhuar në shoqërinë civile dhe në iniciativa të artit bashkëkohor. Është bashkautore e librit “Politikat e kujtimit dhe përkatësisë: Histori të jetës të grave shqiptare në Kosovë” (2006) dhe autore e një numri të artikujve të botuar brenda dhe jashtë vendit. Është ligjëruese në departamentin e etnologjisë të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës. (Linda Gusia)

LUCI Njomëza (1979-). Dizajnere e modës, kostumografe. Lindi në Prishtinë, ku kreu arsimin fillor dhe të mesëm. Mbaroi studimet për dizajn grafik dhe pikturë në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës dhe kreu trajnime për dizajnin e modës në Britani të Madhe dhe Itali. Punoi si kostumografe në Teatrin Kombëtar të Kosovës në shfaqjet: “Arushani & Fejesa” (2005), “Më afër” (2011), “Mbas zonjushës Xhuli” (2013), ndërkaq në Teatrin “Dodona” në shfaqjen “Stjuardesat” (2009). Gjithashtu punoi si skenografe në filmin e shkurtër “Kaseta e dasmës”. (Doruntina Basha)

LUCI Rexhep (1942-2000). Inxhinier i arkitekturës. Lindi në Pejë, shkollimin fillor dhe të mesëm i kreu në Shkup, ndërsa studimet në Fakultetin e Arkitekturës të Universitetit të Beogradit (1969). Pas diplomimit punoi në “Unikos Projekt” dhe në Entin Urbanistik të Prishtinës (1972-1977). Në periudhën 1978-1982 ishte sekretar i Bashkësisë Vetëqeverisëse të Interesit (BVI) për Banim dhe Lokal Afarist, ndërsa në periudhën 1983-1991 ishte udhëheqës i sektorit për planifikim në Entin Urbanistik. Në vitin 2000 u zgjodh drejtor i Drejtorisë për Planifikim dhe Urbanizëm në Prishtinë (2000). Si sekretar i BVI-së për Banim dhe Lokal Afarist ai i vendosi bazat e sistemit të



REXHEP LUCI

termofikimit në Prishtinë. Në këtë periudhë në Prishtinë u ndërtuan mesatarisht 1,000 banesa kolektive në vit, përfshirë kompleksin e lagjeve “Dardania”, “Aktashi” dhe “Bregu i Diellit”. Në këtë periudhë, për herë të parë problemi urban i Prishtinës u shtjellua në Planin e Përgjithshëm Urbanistik (PPU për 1988-2000), të cilin ai e udhëhoqi. Ky plan kishte për qëllim ngritjen e cilësisë së jetës për 195,000 banorë, duke ruajtur vlerat e mjedisit. Pas luftës në Kosovë, R. Luci ishte kundërshtar i ashpër i ndërtimeve të pakontrolluara dhe ilegale në Prishtinë. Plani hapësinor “Prishtina 2000-2005”, ku e paraqiti vizionin për të ardhmen e qytetit, u përfundua më 11 shtator 2000. Në përfundim të asaj dite, ai edhe u vra. (Dervish Qerreti).

LUCI-AGAJ Asene (1940-). Mjeke, histologe, profesore universiteti. Lindi në Pejë. Kreu shkollimin fillor dhe të mesëm në Pejë, studimet në Fakultetin e Mjekësisë në Shkup (1970). Pas diplomimit u emërua mjeke në Prishtinë. Kreu specializimin në Fakultetin e Mjekësisë në Beograd. Në vitin 1972 u zgjodh asistente e lëndës histologji në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. Mbrojti temën e doktoratës në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës (1980) dhe mori titullin e profesorit inordinar për lëndën histologjia me embriologji. Ishte shefe e Institutit të Histologjisë për shumë vjet, që nga themelimi e deri kur u përjashtua me dhunë nga puna më 1990. Si pedagogje e Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë i arriti të gjithë titujt universitarë. Mori pjesë në shumë kongrese e simpoziume dhe botoi një varg punimesh shkencore, si autore dhe bashkautore. (Remzije Belegu)

LUCI-GASHI Lumturie (1951-). Mjeke, patologe, mësimdhënëse universitare. Lindi në Pejë, shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në Pejë, Fakultetin e Mjekësisë e filloi në Prishtinë dhe e kreu në Beograd (1976). U punësua si asistente praktikante në Institutin e Anatomisë Patologjike. Specializimin në lëmin e patologjisë e përfundoi në Fakultetin e Mjekësisë në Zagreb, ku kreu edhe studimet pasuniversitare (1986). Pjesën eksperimentale për tezën e doktoratës e përgatiti gjatë qëndrimit dyvjeçar në shkollën mjekësore të Harvardit në Boston, SHBA. Mbrojti tezën e doktoratës në vitin 2002 në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. Pas largimit me dhunë nga puna, disa herë me radhë

ka përfaqësuar Kosovën në institucionet shëndetësore ndërkombëtare. Pas luftës së vitit 1999 kreu detyra të ndryshme dhe ushtroi funksione me rëndësi në institucionet shëndetësore dhe të arsimit të lartë. Është mësimdhënëse e anatomisë patologjike në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. Mori pjesë në shumë kongrese e simpoziume shkencore dhe publikoi një sërë punimesh shkencore, si autore dhe bashkautore. (Ismajl Dreshaj)

LUFTA DARDANE. Shih: LUFTËRAT DARDANO-ROMAKE.

LUFTA E FERIZAJT (1944). Njëra nga përpjekjet e organizuara të rezistencës antikomuniste për t'iu këndërvënë ripushtimit të Kosovës nga njësitë e Ushtrisë Nacionalçlirimtare Jugosllave. Kështu, Shtabi i Zonës IV për Mbrojtjen e Kosovës nga komunistët dhe çetnikët sllavë, që ishte formuar në kuadër të Lidhjes së Dytë të Prizrenit, e që kishte për obligim mbrojtjen e zonës Ferizaj-Kaçanik-Gjilan, organizoi disa takime me veprimtarët e vet. Në krye të Shtabit ishte Adem Gllavica. Nën udhëheqjen e tij u tubuan rreth 50 veprimtarë, në mesin e të cilëve edhe: Hysen Tërpeza, Idriz Hajrullahu, Muharrem Fejza, Qazim Llugaxhia, Bajrush Kapetani etj. U vendos që të organizohen të gjitha forcat nacionaliste shqiptare për të çliruar dhe shpëtuar Ferizajn dhe Gjilanin nga masakrat e komunistëve dhe çetnikëve serbë. U caktuan edhe prijësit e këtyre operacioneve. Për Ferizajin u caktuan: Adem Gllavica, Hysen Tërpeza dhe Qazim Llugaxhia; për Gjilan: Idriz Hajrullahu, Sylë Zarinca dhe Muharrem Fejza. Në mëngjesin e 2 dhjetorit të vitit 1944, Adem Gllavica me bashkëluftëtarët e vet, në krye të rreth 2,000 vullnetarëve, mësyu dhe për një kohë të shkurtër depërtuan në disa pjesë të qytetit të Ferizajt. Ata morën ndërtesën e xhandarmërisë dhe kazermat që ishin të zbrazëta, depërtuan deri te kisha katolike, te lagja e malazezëve, kulla e Bakiqëve dhe deri te ndërtesa në të cilën ishte i vendosur Shtabi i Brigadës II të Kosovës, efektiveve të së cilës i erdhën në ndihmë edhe popullsia sllave e qytetit dhe e fshatrave përreth. Gjatë luftimeve forcat partizane përdorën edhe artilerinë kundër shqiptarëve, derisa nga ana e Gjilanit atyre iu erdhën në ndihmë një batalion i Brigadës III të Kosovës. Ndihma iu erdhën edhe nga Prishtina e Shkupi. Luftimet zgjatën tërë ditën, aty-këtu edhe të nesërmen.

Për shkak të raportit të pabarabartë të forcave, njësitet vullnetare shqiptare u detyruan të tërhiqen. Kjo luftë nga pushteti komunist u shfrytëzua si shkas për masakër të re mbi popullsinë e pambrojtur shqiptare. Vetëm gjatë 2-3 ditëve u vranë dhe u plagosën rreth 1,500 shqiptarë. Edhe forcat partizane patën humbje të konsiderueshme. (Fehmi Rexhepi)

LUFTA E GJILANIT (1944). Njëra nga përpjekjet e organizuara të forcave nacionaliste shqiptare për ta shpëtuar Gjilanin nga masakrat dhe krimet e njësiteve serbo-maqedone të Ushtrisë Nacionalçlirimtare Jugosllave (UNÇJ). Pas tërheqjes së forcave gjermane dhe depërtimit të njësiteve të UNÇJ-së dhe forcave bullgare, në Gjilan filloi konsolidimi i pushtetit komunist e riaktivizimi i elementeve çetnike serbo-malazeze, që filluan vrasjen në masë të shqiptarëve. Për çdo mbrëmje pushkatoheshin 40-50 vetë. Vetëm për një natë u pushkatuan 140 shqiptarë, në mesin e të cilëve edhe intelektualë të shquar të kësaj ane, siç ishin gazetari Sylejman Ashkiu dhe avokati Esat Berisha, anëtarë të KQ të Lidhjes së Dytë të Prizrenit. Për shkak të kësaj rrethane, në Gjilan e rrethinë filloi vetorganizimi i forcave vullnetare për mbrojtje. Ata formuan shtabin e rezistencës me komandant Idriz Hajrullahun, sekretar Muharrem Fejzën dhe anëtarë Sylë Zarbincën dhe Shefki Ajdinin. Pas luftimeve që zhvilluan natën mes 19 e 20 dhjetorit kundër Brigadës XVII maqedone rreth fshatrave Desivojcë, Qarr e Vruçec, forcat vullnetare korrën fitore, ndërsa partizanët maqedonas të shpartalluar u tërhoqën disa në Gjilan dhe disa në Bujanoc. Pas kësaj fitoreje, forcat vullnetare arritën në Ropotovë, për të bërë përgatitjet për ta sulmuar Gjilanin. Në qytet, përveç Brigadës XVII Maqedone, njësiteve të OZN-ës dhe komandës së vendit, ishin mobilizuar edhe qytetarët serbë e malazezë. Forcat kryengritëse në mëngjesin e 23 dhjetorit 1944 sulmuan Gjilanin në tri drejtime dhe shtinë në dorë pjesën më të madhe të qytetit, me ç'rast njësitet partizane dhe ato të OZN-ës u tërhoqën në panik në periferi, për të pritur ndihmë nga Ferizaj dhe Prishtina. Gjatë luftimeve të ashpra që u zhvilluan në qytet, u vra edhe njëri nga udhëheqësit e luftës, Shefki Ajdini-Desivojca. Luftëtarët shqiptarë, edhe pse e morën pjesën më të madhe të qytetit, për shkak të përforcimeve që u erdhën nga Prishtina, për

të kursyer popullsinë civile, u tërhoqën po atë ditë nga qyteti. Nga luftimet patën humbje të dyja palët, por humbjet më të mëdha i pësoi popullsia civile, ngase pas tërheqjes së forcave shqiptare njësitet e Brigadës XVII Maqedone, pjesëtarët e OZN-ës dhe grupet e serbëve të qytetit bënë masakër mbi popullsinë shqiptare. Masakrën e pranuan edhe udhëheqësit politikë dhe ushtarakë të asaj kohe, si Halil Fejzullahu (komisar i komandës së vendit), Lubo Shotra (shef i OZN-ës në Gjilan), Hajredin Vullkani (luftëtar i Brigadës V të Kosovës), përfshirë edhe komandantin e Shtabit Operativ të UNÇ të Kosovës, Fadil Hoxhën. (Fehmi Rexhepi)

LUFTA E LIVOÇIT (1943). Përballje luftarake në mes Aradhes partizane "Emin Duraku" dhe forcave italiane, që u zhvillua në Livoç të Epërm, 5 km afër Gjilanit. Aradhja "Emin Duraku" nga Gjakova u nis për në Gjilan, me qëllim që të takohej me Svetozar Vukamanoviq-Tempon dhe Pavle Joviqeviqin, por u rrethua në Livoç të Epërm nga njësitet ushtarake italiane dhe vullnetarë vendorë. Komandanti i Aradhes "Emin Duraku", Fadil Hoxha, me anën e korrierit Sami Pejës njoftoi për rrethimin Komitetin e Rrethit të Gjilanit, ndërkaq edhe Hasan Dylgjeri, nëpërmjet nënprefektit Rifat Berisha dhe veprimtarëve të tjerë me ndikim, sidomos Ramiz Cërnics dhe Hysen Tërpezës ndikuan dhe neutralizuan vullnetarët. Aradhja kishte rreth 30 luftëtarë të armatosur. Pas një luftimi të shkurtër, filluan bisedat në mes Fadil Hoxhës dhe prijësve të vullnetarëve. Fshatarët premtuan se nuk do të shtinin kundër partizanëve. Me ardhjen e përforcimeve nga Gjilani, filluan të shtënat ndërmjet karabinierëve dhe partizanëve, por fshatarët nuk u përfshinë. Pasi u errësua, ata u hapën rrugë partizanëve për tërheqje. Në këtë përballje u vra zëvendëskomisari i aradhes Musa Zajmi. Humbjet e italianëve nuk u bënë të ditura. (Fehmi Rexhepi)

LUFTA E PARË BALLKANIKE (1912). Luftë e koalicionit ballkanik për t'i shkëputur territoret Perandorisë Osmane. Lufta filloi në tetor të vitit 1912 dhe zgjati deri në maj të viti 1913. Midis aleatëve ballkanikë (Serbia, Greqia, Mali i Zi dhe Bullgaria) kishte edhe mosmarrëveshje lidhur me ndarjen e territoreve që do t'i shkëputeshin Perandorisë Osmane. Aleatët ballkanikë shfrytëzuan dobësimin ushtarak të Perandorisë dhe problemet e brendshme politike

në Stamboll. Lufta e Parë Ballkanike filloi më 18 tetor 1912. Aleatët ballkanikë i shkaktuan Perandorisë Osmane humbje të rënda dhe të njëpasnjëshme në të gjitha frontet e luftës. Ndeshja më e përgjakshme u zhvillua në Betejën e Kumanovës, ku pati shumë të vrarë e të plagosur nga të dy palët, por që u fitua nga koalicioni ballkanik. Lufta midis palëve ndërluftuese në vazhdim u zhvillua rreth qyteteve Shkodër, Janinë dhe Edrene. Këto qytete u mbajtën të rrethuara nën kërcënimin e forcave serbe, malazeze, greke dhe bullgare. Humbjet e ushtrisë osmane në këto zona krijuan kushte të volitshme për të pushtuar territoret shqiptare dhe territore të tjera të banuara me maqedonas. Ushtria serbe, bashkë me atë malazeze, brenda një kohe të shkurtër pushtuan qytetet kryesore të Kosovës, si Prishtinën, Prizrenin dhe Gjakovën. Më pas kaluan Drinin dhe nëpër Rrafshin e Dukagjinit iu drejtuan Shkodrës. Një pjesë e reparteve ushtarake serbe dhe malazeze pushtuan Mirditën, Lezhën, Krujën, Tiranën dhe Durrësin. Disa njësi të tjera serbe marshuan në drejtim të Shkupit, duke pushtuar Manastirin, Ohrin, Dibërën, Strugën, për të kaluar më pas në Elbasan dhe në zona të tjera të Shqipërisë së Mesme. Në jug grekët, pas sukseseve të vazhdueshme dhe fitoreve në Thesali dhe Epir, morën Sazanin, Himarën dhe krahinat e tjera përreth. Nga ana tjetër, shqiptarët e kishin shumë të vështirë përballjen me forcat serbe, malazeze dhe greke, meqë ishin të lodhur nga kryengritjet antiosmane dhe e kishin të pamundur përballjen me aleancën ballkanike për shkak të forcave jo të barabarta si në njerëz, ashtu edhe në armatime. Perandoria Osmane, duke parë se kishte humbur në të gjitha frontet e luftës, kërkoi ndërhyrjen dhe ndërmjetësimin e Fuqive të Mëdha. Më 30 maj 1912 u nënshkrua Traktati i Paqes ndërmjet fuqive ndërluftuese. Sipas Traktatit, Perandoria Osmane humbte zotërimet e veta në Ballkan, me përjashtim të pak territoreve pranë ngushticave të Bosforit dhe Dardaneleve. Gjithashtu, sipas kësaj marrëveshjeje, Perandoria Osmane hiqte dorë nga Shqipëria dhe ua njihte të drejtën Fuqive të Mëdha të caktonin kufijtë dhe të vendosnin për të ardhmen e saj. (Jusuf Bajraktari)

LUFTA E SERBISË DHE E MALIT TË ZI KUNDËR PERANDORISË OSMANE (1876-1878). Luftë për pavarësi dhe zgjerim të

territoreve të principatave të Serbisë dhe Malit të Zi. U zhvillua në dy faza. Në fazën e parë, me nxitjen dhe përkrahjen e Perandorisë së Rusisë, në fund të qershorit dhe në fillim të korrikut të vitit 1876, Principata e Serbisë dhe Principata e Malit të Zi i shpallën luftë Perandorisë Osmane. Ushtritë e principatave sllave pësuan disfatë përballë forcave ushtarake osmane. Me ndërhyrjen e Rusisë më 31 tetor 1876, Porta e Lartë firmosi armëpushimin me Principatën e Serbisë, kurse Principata e Malit të Zi e vazhdoi luftën pa ndonjë sukses të rëndësishëm. Në fazën e dytë, gjatë luftës ruso-osmane 1877-1878, Principata e Serbisë dhe Principata e Malit të Zi në fund të vitit 1877 rifilluan luftën kundër Perandorisë Osmane në drejtim të jugut, duke arritur fitore të rëndësishme. Ushtria serbe marshoi pa ndonjë pengesë drejt vilajetit të Kosovës dhe mori Pirotin, Nishin, Kurshumlinë dhe Vranjën dhe në fund të janarit 1878 arriti në Gjilan. Gjatë janarit 1878, ushtria malazeze pushtoi Tivarin, Ulqinin dhe arriti në brigjet e Liqenit të Shkodrës dhe të lumit Buna. Me vendimet e Traktatit të Shën Stefanit dhe të Kongresit të Berlinit, Serbisë dhe Malit të Zi iu njoh pavarësia, ndërsa kufijtë e tyre u zgjeruan në dëm të territoreve osmane të banuara kryesisht me shqiptarë. (Fitim Rifati)

LUFTA RUSO-TURKE (1828-1829). Luftë e Rusisë kundër Perandorisë Osmane (1828-1829), e cila përfundoi me paqen e Edrenesë (1829), me të cilën Rusia mori grykën e Danubit dhe bregdetin e Kaukazit në Detin e Zi. Këtë luftë e shfrytëzoi Serbia dhe Greqia dhe në bazë të paqes së Edrenesë, Serbia fitoi autonominë, kurse Greqia, me vendimin e Fuqive të Madha, fitoi pavarësinë (1830). Autonomi fituan edhe Moldavia e Vllahia. Trupat ruse depërtuan në lindje, për shtatë ditë marshuan në Moldavi, ndërsa nëpër Kaukaz depërtuan në Anadollinë Lindore. Kaluan malet Ballkanike dhe morën Edrenenë për tri ditë. Ushtria osmane e papërgatitur, si dhe bllokimi i marinës së saj në Mesdhe, nga francezët në Algjeri, bëri që deri në verë 1829 rezistenca osmane të thyhej, duke pësuar disfatë të rëndë. Në këtë situatë të vështirë, Porta e Lartë i drejtoi sytë në Shqipëri, me synim që forcat e Shqipërisë Veriore t'i drejtonte për frontin e Danubit, për ta zhbllokua Vidinin, i cili rrezikohet të binte nën rusët. Për këtë angazhoi Mustaf Pashë Bushatliun dhe feudalët e tjerë të Kosovës,

të cilët formuan ushtrinë shqiptare, sipas sistemit të vjetër. Më 6 korrik 1829, ushtria prej 25,000 trupash arriti të mbronte Vidinin dhe e detyroi ushtrinë ruse në Orahovë të braktiste këtë qytet. Sulltanit i shërbeu kjo fitore si mbështetje për të dërguarit e tij diplomatike, kurse Mustafë Pashën e caktoi kryekomandant të korparmatës së Rumelisë Qendrore. Rusët ishin të shqetësuar, sepse Mustafë Pasha shtoi potencialin ushtarak edhe me reparte rezervë. Ai mund t'ua merrte përsëri Edrenenë rusëve, por sulltani nuk pranoi zgjatjen e luftimeve dhe urdhëroi nënshkrimin e traktatit të paqes. (Aliriza Selmani)

LUFTËRAT AUSTRO-OSMANE (1683-1699). Luftë e gjatë ndërmjet Perandorisë Osmane dhe Habsburgëve të Austrisë, e cila nisi me rrethimin e dytë të Vjenës (1683). Rrethimi i Vjenës zgjati dy muaj dhe, në momentet më kritike, më 12 shtator 1683, ushtria e përbashkët polako-habsburge e theu ushtrinë osmane në Betejën e Kalenbergut.

Nga viti 1684, kur me iniciativën e Papës u themelua Lidhja e Shenjtë (Perandoria Habsburge, Polonia, Venediku dhe Rusia) e deri në vitin 1688, ushtria e Lidhjes së Shenjtë arriti t'i zmbrapsë osmanët pothuaj nga gjithë Hungaria. Osmanët humbën edhe Budimin, si dhe pjesë të Sllavonsë, Vojvodinës, Bosnjës, Dalmacinë dhe Malin e Zi. Austriakët më pas pushtuan Sremin dhe Beogradin (1688) dhe një vit më vonë vazhduan në jug, me synim ta pushtonin Maqedoninë dhe, nëpërmjet Kosovës dhe Shqipërisë, të dilnin në Adriatik. Pasi pushtuan Nishin (1689) popujt krishterë të kësaj pjese të Ballkanit ishin gati për një kryengritje të përgjithshme, duke iu bashkuar ushtrisë austriake si reparte vullnetare. Nga Nishi ushtria austriake vazhdoi në dy drejtime. Konti Ludvig Baden, komandant i përgjithshëm i forcave austriake, u nis drejt Vidinit, ndërkaq gjenerali Pikolomini depërtoi në jug, duke pushtuar pjesë të rëndësishme të Kosovës dhe të Maqedonisë. Pas vdekjes së Pikolominit (1689), rrjedha e luftës mori kahe tjetër, sepse Porta e Lartë arriti shpejt ta riorganizonte ushtrinë e saj. Brenda pak muajsh ushtria osmane, nën komandën e Mustafa Pashë Qypërliut dhe Halil Pashës, e ktheu serish Maqedoninë dhe Kosovën nën administrimin osman. Rrjedhimisht, ushtria austriake humbi me radhë Pirotin, Nishin, Beogradin dhe bashkë me një

numër kryengritësish ballkanikë u largua drejt Hungarisë. Përlleshje sporadike pati gjatë pranverës së vitit 1691, por konfrontimi më i madh ndërmjet dy palëve ndodhi në gusht të vitit 1691, te Sllankameni, në Srem. Këtu ushtria osmane pësoi disfatë të thellë, por austriakët nuk patën guxim të vazhdonin tutje. Të dërrmuara financiarisht nga lufta e gjatë, të gjitha palët ishin të interesuara për përfundimin e saj. Me ndërmjetësimin e Holandës dhe Anglisë nisën bisedimet për paqe në Karlloc (nëntor 1698) ndërmjet Aleancës së Shenjtë dhe Perandorisë Osmane. Traktati i paqes u nënshkrua më 26 janar 1699. Sipas dispozitave të Paqes së Karllocit, secila palë do t'i mbante ato territore që i kishte në dorë në momentin e nënshkrimit të traktatit të paqes. Perimetri territorial i Perandorisë Osmane u zvogëlua mjaft. Nga kjo paqe Perandoria Osmane mori një goditje të rëndë, sepse bëri lëshime të mëdha territoriale dhe, prej asaj kohe, nuk paraqiste më kërcënim serioz për Fuqitë e Mëdha të Europës. (Gazmend Rizaj)

LUFTËRAT DARDANO-MAQEDONASE.

Luftëra që u zhvilluan midis dardanëve dhe fqinjëve të tyre jugorë, maqedonasve. Dëshmitë e para të shkruara për historinë politike të Dardanisë u paraqitën nga viti 345 p.e.r., kur Dardania hyri në sferën e interesit të Maqedonisë dhe të interesimit të shkrimtarëve antikë, ndërsa luftimet dardano-maqedonase gjatë periudhës helenistike bënë që shkrimtarët antikë t'i shohin dardanët si "armiqësor ndaj maqedonasve" (gens semper infestissima Macedoniae). Në vitin 344/43 p.e.r. mbreti Filipi II luftoi kundër Dardanisë për t'i zgjeruar dhe përforcuar kufijtë veriorë. Dardanët i humbën pjesët jugore, por u fuqizuan më shumë pas vdekjes së mbretit të Maqedonisë (336 p.e.r.). Madje, Aleksandri i Madh, para rrugetimit për ta pushtuar ekumenën, i siguroi kufijtë veriorë, duke luftuar në Dardani, pos në Peoni dhe me ilirët e tjerë. Duke iu kundërvënë Maqedonisë, mbreti dardan i ofroi strehim trashëgimtarit të fronit peon, Aristonit, pasi Lizimahu, mbreti i Maqedonisë, e pushtoi Peoninë dhe nuk e kurorëzoi për mbret (284 p.e.r.). Në fillim të shek. III p.e.r. dardanët ishin aq të fuqishëm, sa që Ptoleme Keraunit të Maqedonisë i ofruan ndihmë prej 20,000 ushtarësh në luftë kundër invazionit kelt (279 p.e.r.). Nga mesi i shek. III p.e.r. dardanët u bënë populli më i fuqishëm

i brendisë së Ballkanit, andaj dhe Antigoni Dozoni i Maqedonisë lavdërohet për qetësimin e dardanëve dhe thesalëve, të gëzuar nga vdekja e Demetrit.

Sulmet më të ashpra dardane kundër Maqedonisë u zhvilluan gjatë viteve 221-179, në kohën kur Filipi V luftonte kundër etolëve dhe Spartës. Në vitin 219 p.e.r., gjatë sundimit të mbretit Longar, dardanët i dëbuan maqedonët nga Peonia, e çliruan qytetin Bylazora (sot Veles) dhe zotëruan pjesë të madhe të Peonisë. Në vitin 216 p.e.r. dardanët e detyruan Filipin V t'i ndërpresë luftimet me romakët, pasi i kishin shkretuar tokat maqedone dhe kishin marrë "20,000 robër". Në vitin 211 p.e.r. Filipit V pushtoi qytetin e dardanëve, Sintia, dhe fitoren kundër dardanëve e la trashëgimi me mbishkrim përkushtuar Athenës së Lindit në akropolin e Lindosit. Lufta për Bilazorën, qytet strategjik, ishte e vazhdueshme. Më 209 p.e.r. qyteti ra në duart e Filipit, por kjo nuk i ndaloi dardanët që në aleancë me Aeropin, sovran i rajonit ilir rreth qytetit Lychnid (sot: Ohër), ta vërshojnë Maqedoninë, ta pushtojnë Orestidën dhe të depërtojnë deri te Argea, duke marrë me vete 20,000 robër. Operacionet mbrojtëse dhe sulmet dardane kundër maqedonasve vazhduan edhe pas vdekjes së Filipit V.

Dardanët lidhën aleancë me romakët, u bënë pjesë e koalicionit antimaqedon dhe morën pjesë në Luftën e Dytë Romako-Maqedone. Nga presioni dardan, Filipi V u detyrua që nga Pellagonia ta dislokojë ushtrinë dhe sërish t'u hapë rrugë dardanëve në drejtim të jugut. Në verë të vitit 197 p.e.r., pas betejës së Kinosefalës, dardanët dominuan veriu e Maqedonisë, andaj Filipi V dërgoi 6,000 këmbësorë dhe 500 kalorës, duke i mundur te Stobi. Filipi V tentoi që t'i zhdukë dardanët edhe përmes bastarnëve. Për këtë e ndaloi vdekja, por as biri i tij, Perseu, nuk arriti ta realizojë, ndonëse më 176 p.e.r. 30,000 bastarnë hynë në Dardani dhe dardanët e organizuar mirë i dëbuan. Ndërkohë, Perseu pushtoi pjesët jugore të Dardanisë, dogji dhe shkatërroi hapësirën rreth Malit Skard (Sharri) dhe krijoi tampon zonë, të njohur në burime si "Iliria e shkretë". Në vitin 168 p.e.r. Maqedonia ra përfundimisht nën protektoratin romak. Dardanët ndikuan dukshëm në dobësimin dhe rënien e shtetit dikur të fuqishëm të Maqedonisë, por vazhduan të bashkëpunonin me maqedonasit sipas nevojës, për t'iu kundërvënë romakëve. (Edi Shukriu)

LUFTËRAT DARDANO-ROMAKE. Luftërat që i zhvilluan dardanët kundër pushtimeve romake. Dardanët prishën aleancën me romakët, kur këta krijuan provincën romake të Maqedonisë (168 p.e.r.) dhe u bënë fqinjë jugorë të dardanëve, duke mos ia kthyer territoret në Peoni, të cilat dardanët i konsideronin të vetat dhe për të cilat luftuan gjatë me Maqedoninë. Duke fituar vetëm të drejtën për tregti me kripë në Stobi, dardanët dolën nga koalicioni antimaqedon dhe nisën politikë të pavarur me forcimin e lidhjeve me aleatët, siç ishin etolët dhe medët e shteti ilir.

Revolta e dardanëve u shndërrua në një konflikt të përhershëm me romakët. Kështu, dardanët i përkrahën maqedonët dhe i ofruan strehim Androniksit, pretendentit për fron, pasi ky u ngrit në Maqedoni kundër dominimit romak. Aleanca dardane me medët mbështetej në aksionet e përbashkëta kundër provincës romake të Maqedonisë dhe të ndalimit të depërtimit të legjioneve romake në drejtim të veriut. Aksionet e dardanëve u akorduan me zhvillimet politike dhe ushtarake në Pont, kur Mitridati i nxiti dardanët, medët dhe skordiskët të depërtonin deri në faltoren e Delfit (84 p.e.r.). Ndonëse konsulli romak Scipioni i largoi nga Greqia, ky bëri marrëveshje me dardanët dhe medët, pasi këta e blenë me "një sasi ari të grabitur në faltore". Forcat dardane nuk u mposhtën as pas luftimeve të konsujve romakë, Vulsonit (97 p.e.r.), Sulës (85 p.e.r.) e legatit të tij (77/6 p.e.r.).

Duke parë se dardanët nuk mund të mposhteshin lehtë, forca të mëdha romake u nisën nga Dyrrahu që ta thyejnë rezistencën dardane në pranverë të vitit 75 p.e.r. Nën udhëheqjen e Kurionit ishin pesë legjione romake, me mbi 30,000 ushtarë. Operacioni u pa aq i rrezikshëm, sa që një legjion refuzoi të nisej për në Dardani. Për tri vjet rresht u zhvilluan luftime të tmerrshme në Dardani (75-73). Fitorja mbi dardanët dhe ndëshkimi i egër i tyre i mundësoi Kurionit edhe pushtimet në drejtim të veriut dhe ai u bë prijësi i parë romak që depërtoi në Danub. Suksesi i fitores mbi dardanët ishte aq i madh, sa që Kurionit iu organizua hyrja triumfale në Romë (72 p.e.r.). Ndëshkimi romak nuk e ndali rezistencën dardane, të cilët shkatërruan edhe ushtrinë e prokonsullit Hibrida, i cili ishte në krye të legjioneve romake në Ballkan. Duke e parë ende rrezikun nga dardanët, në vitin 38 p.e.r. triumviri Mark Antoni e dërgoi ushtrinë

që të luftojë përsëri në Dardani, ndërsa në vitin 29 p.e.r. Mark Krasi luftoi edhe kundër dardanëve. Vetëm pas luftës së Mezisë (28 p.e.r.) romakët filluan ta lidhin fatin e Dardanisë me provincën e ardhshme romake të Mezisë dhe pastaj të Mezisë së Epërme. Romakëve u është dashur gjatë të ballafaqohen me rezistencën dardane, kryesisht deri në krijimin e provincës romake të Dardanisë (279), e cila u bë pjesë e prefekturës së Ilirikut. (Edi Shukriu)

LUFTËRAT E KIKËS (1944). Dy luftëra të zhvilluara ndërmjet Ushtrisë Shqiptare dhe forcave vullnetare, në njërën anë, dhe njësiteve partizane serbo-maqedonase, në anën tjetër, gjatë qershorit dhe korrikut të vitit 1944. Vullnetarët e Gjilanit dhe të rrethinës u dolën në ndihmë forcave kufitare gjatë verës e vjeshtës së vitit 1944, duke u shkaktuar humbje njësiteve partizane serbe, maqedonase dhe bullgare. Luftime të rrepta u zhvilluan sidomos në Kikë, mbi Hogosht dhe afër Preshevës. Sulmeve partizane në luftërat e Kikës iu bënë ballë një numër i vogël ushtarësh dhe vullnetarësh, të cilëve u printe kolonel Fuad Xhaferaj-Dibra, komandanti i Regjimentit IV të Ushtrisë Shqiptare, kapitenët Shefqet Bylykbashi dhe Sabit Basha, ushtarakët Nazmi Budrika, Gjon Martini, Demir Korça e dhjetëra komandantë të njësiteve kreshnike të Kosovës. Frymëzues i këtyre luftërave ishte Idriz Hajrullahu. Lufta e parë e Kikës u zhvillua më 28 dhe 29 qershor dhe përfundoi me humbje të konsiderueshme të të dy palëve. Në këtë luftë sulmuan forcat e Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Jugosllavisë, ku bënë pjesë edhe Brigada XIII Serbe, aradhja e Vranjës, Divizioni i 22-të Serb me komandantin e shtabit të Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Serbisë, Petar Stambolliqin. Këto forca që operonin në Jabllanicë, Pçinjë, Cërnatravë dhe Moravë Jugore synonin të depërtonin në Kosovë. Kufiri ruhej nga ushtria dhe nga forcat vullnetare, të cilat organizoheshin nga Komiteti i Rinisë për Mbrotjtjen e Kosovës, që vepronte në kuadër të Lidhjes II të Prizrenit. Në këtë luftë, që u zhvillua në Kikë dhe Velegllavë, partizanët patën 200 të vrarë dhe 131 të zënë robër lufte, ndërsa shqiptarët patën 16 të vrarë dhe 20 të plagosur. Vetëm një numër i vogël partizanësh e çetnikësh shpëtuan, duke u tërhequr në territorin e Serbisë. Të zënë robër në Hogosht iu dha ndihmë dhe ushqim. Të plagosurit u bartën me qerre në spitalin

e Gjilanit. Prej të zënëve robër vetëm një kishte qenë shqiptar, Ymer Fejza-Molla nga Sfirca, i cili u pushkatua si bashkëpunëtorë i komunistëve serbë.

Lufta II e Kikës u zhvillua më 26 korrik, gjithashtu në mes partizanëve dhe forcave ushtarake e vullnetare shqiptare. Partizanët me forcat çetnike mësynë edhe një herë të depërtonin në drejtim të Hogoshtit, përkatësisht të Kosovës. Luftimet zgjatën tërë ditën. Forcat serbe ishin shumë më të mëdha dhe përbëheshin nga shumë njësite të divizioneve sulmuese. Forcave kufitare iu arritën në ndihmë vullnetarët nga popullsia e zonës. Forcat partizane, edhe pse kishin depërtuar 2 km në territorin e Kosovës, u detyruan të tërhiqen, duke lënë 70 të vrarë e shumë të plagosur vetëm në territorin e Hogoshtit. Nga radhët e shqiptarëve pati 45 të vrarë dhe 90 të plagosur. Këto luftëra nxiteshin kryesisht nga forcat çetnike, të cilat ishin përfshirë në njësitet partizane. (Fehmi Rexhepi)

LUFTËRAT PËR LIPJANIN (SHEK. XI-XIII). Gjatë periudhës mesjetare Lipjani u shqua si qendër peshkopale gjeostrategjike, meqë aty kryqëzoheshin rrugët që çonin për në Zveçan, Trepçë, Prishtinë, Novobërdë dhe Shkup. Kronisti bizantin, Joan Skylitza, e përmend Lipjanin në vitin 1018, në kontekst të rikthimit të qyteteve bizantine të pushtuara më parë nga bullgarët. Nga fundi i shek. XI, Lipjani dhe Zveçani u sulmuan nga Vukani, zhupan i Rashës. Në vitin 1093, Lipjani u plaçkit dhe u dogj nga Vukani dhe kjo ngjarje i dha shkak Aleksit I Komnenit (1081-1118) të përgatiste një fushatë për ta ndëshkuar zhupanin rasan, i cili atëbotë ishte fshehur në Zveçan dhe kishte premtuar se nuk do ta trazonte më kufirin bizantin. Megjithatë, zhupani nuk e kishte mbajtur premtimin, sepse ndërkohë sulmoi trevën e Shkupit dhe Pollogun (1094). Po në këtë vit perandori bizantin, Aleks I, kishte arritur në Lipjan dhe pas negociatave ishte arritur paqja, por kësaj radhe duke mbajtur peng fëmijët e Vukanit (Uroshin dhe Stefanin). Nga kjo marrëveshje dhe deri në vitin 1180, përkatësisht 1190 nuk kemi ndonjë njoftim lidhur me luftërat e zhvilluara për Lipjanin. Në këto vite qyteti pushtohet nga Stefan Nemanja. Nga mesi i shek. XIII (1267-1269), Lipjani përmendet në kontekstin e një marrëveshjeje për martesën e Milutinit (mbret i ardhshëm i Rashës) me Anën, vajzë e perandorit Mihali VIII Paleologu (1259-1282). Në vitin 1283, kur

tartarët vërshtuan Ballkanin, ata kishin depërtuar edhe deri në Lipjan dhe Prizren, por qenë të detyruar që të tërhiqeshin. Nga kjo kohë, deri me pushtimin osman në vitin 1455, bashkë me qytetet e tjera të Kosovës, historia e Lipjanit nuk shënon ndonjë ngjarje të rëndësishme për kohën. (Muhamet Mala)

LUFTËRAT PËR PRIZRENIN (SHEK. XI-XIV). Për Prizrenin, si qendër e rëndësishme tregtare dhe ekonomike, gjatë mesjetës janë zhvilluar një sërë luftrash. Prizreni u shndërrua në një qendër të kryengritjes kundër pushtetit bizantin nga feudalët vendorë në kryengritjen e viteve 1072-1073, të udhëhequr nga Kostantin Bodini dhe Gjergj Vojteku. Pas kësaj kryengritjeje, për pushtimin e qytetit rreth vitit 1190 luftoi edhe zhupani i Rashës, Vukani. Me vdekjen e perandorit Mihail Komnenit (1180), Bizanti hyri në krizë të thellë politike dhe ushtarake. Stefan Nemanja e shfrytëzoi këtë rrethanë për të zgjeruar pushtetin e vet në drejtim të jugut. Ai shkatërroi dhe pushtoi Prizrenin pas Betejës së Pantinës (1169). Ndërkaq, pas Kryqëzatës IV, Bizanti u kthye sërish në skenën ballkanike. Në vitin 1190 Bizanti arriti fitore kundër Stefan Nemanjës në Betejën e Moravës. Sipas marrëveshjes së nënshkruar, Nemanja u detyrua t'i rikthente territoret e pushtuara gjatë viteve të fundit, pra edhe qytetin e Prizrenit. Pas kësaj, për një kohë të shkurtër, pas vitit 1204 Prizreni do të qëndrojë nën sundimin bullgar dhe të despotëve të Epirit. Rreth vitit 1216, në kohën e Stefanit të Parë të Kurorëzuar, Prizreni sërish u pushtua nga Rasha, për të qëndruar në duar të tyre deri në vitin 1371. Në këtë vit Prizreni zotërohej nga dinastia e Balshajve. Pas humbjes në Betejën e Savrës (1385) dhe inkursioneve të vazhdueshme osmane, Balshajt do ta humbin Prizrenin, i cili kaloi në duar të Kastriotëve dhe më pas të Dukagjinëve. Pas Betejës së Dytë të Kosovës (1448) osmanët e shtuan presionin e tyre ndaj qendrave vasale të Kosovës. Beteja e fundit mesjetare për pushtimin e Prizrenit u zhvillua më 21 qershor 1455, kur osmanët përfundimisht e pushtuan Prizrenin, sundimi i të cilëve zgjati deri më 1912. (Muhamet Mala)

LUFTËRAT RUSO-OSMANE (1877-1878). Në verë të vitit 1876 Serbia dhe Mali i Zi filluan luftën kundër Perandorisë Osmane. Disfata që pësuan ushtritë e tyre krijuan përshtypje se

Rusia nuk do të përzihej në situatën e krijuar në Ballkan. Por Rusia së shpejti filloi luftën kundër Perandorisë Osmane. Takimet që u mbajtën në Stamboll e Londër nuk dhanë rezultate. Në prill të vitit 1877 Rusia i shpalli luftë Perandorisë Osmane. Sukseset e ushtrisë ruse qenë të mëdha. Në shkurt të vitit 1878, ajo arriti afër Stambollit. Kjo situatë krijoi shqetësime te shtetet e Europës e në veçanti tek Anglia, e cila nuk do të lejonte pushtimin e Stambollit, marrjen e Grykës së Bosforit dhe daljen e Rusisë në Mesdhe. Nën presionin e Fuqive të Mëdha të asaj kohe u mor vendim për thirrjen e një mbledhjeje, e cila u mbajt në Shën Stefan, në periferi të Stambollit. Në paqen e Shën Stefanit shtetet e Ballkanit (Serbia, Mali i Zi, Bullgaria dhe Greqia) u zgjeruan në dëm të tokave shqiptare. (Isa Bicaj)

LUGINA E PRESHEVËS. Shtrihet në pjesën verilindore të trungut gjeoetnik shqiptar. Kufirin perëndimor të saj e përbën mali i Karadakut të Preshevës në jug dhe Malësia e Bujanocit në veri, kurse në lindje mali i Rujanit dhe i Kozjakut. Nga fusha e Kumanovës në jug ndahet me ujëndarësin e ulët të Preshevës, e njohur si kërrusja e Preshevës (460 m lartësi mbidetare). Shtrihet përgjatë luginave qendrore të Gadishullit Ballkanik, asaj të Moravës dhe të Vardarit. Nëpër territorin e saj kalojnë hekurudha (e ndërtuar në vitin 1888) dhe magjistralja automobilistike Beograd-Nish-Shkup, e ndërtuar në fillim të viteve '60 të shek. XX. Paralel me rrugën e re shkon rruga me karakter rajonal, e njohur si "Xhadja e vjetër". Këto vija të komunikacionit janë pjesë përbërëse e të ashtuquajturit "Korridor i X", njërit prej korridoreve më të rëndësishme në Europën Juglindore, i njohur si boshti primar meridional ballkanik.

Pozita e volitshme gjeokomunikuese dhe baza e mirë gjeografike-natyrore kanë mundësuar që territori i Luginës së Preshevës të banohet qysh në kohët e hershme. Ajo shtrihet brenda kufijve të grupit kulturor dardan. Dëshmi për këtë janë kështjellat dhe objektet e tjera, si Kalaja e Preshevës, Kalaja e Bushtranit, Kacipupi (Oppidum dardan) etj.

Lugina e Preshevës, si tërësi, është e shtrirë në një territor prej afër 1,250 km², në të cilin jeton një popullatë shqiptare rezidente prej rreth 100,000 banorësh, që aktualisht përbën rreth 80% të popullsisë së përgjithshme rezidenciale të rajonit. Nga 136 vendbanime, sa ka ky

territor, popullsia shqiptare shtrihet në 64 sish të tipit rural dhe në tri qendra të karakterit urban të komunave të Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës. Shqiptarët me shumicë absolute jetojnë në 41 vendbanime. Përveç selive komunale, edhe disa vendbanime rurale janë të përziera në pikëpamje etnike, ku dominojnë shqiptarët. Para katër dekadash në shumë vendbanime kishte më tepër popullsi të përzier, ku serbët ishin me prejardhje kolonizuese, të instaluar nga koha e pushtimit të Kosovës dhe Maqedonisë në vitin 1912 dhe veçanërisht pas konstituimit të Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene, me vendimin e Konferencës së Versajës (1919).

Lugina ishte dhe mbeti rajoni më i pazhvilluar në Serbi dhe në Ballkan: pjesët e banuara me shqiptarë sot janë më se shtatë herë më të pazhvilluara se mesatarja e Serbisë. Shqiptarët e atjeshëm deri vonë jetonin vetëm nga bujqësia ekstensive dhe natyrale, ndërsa sot kryesisht jetojnë nga remitancat që i sjellin emigrantët e punës në vendet e Europës dhe jashtë saj. Rreth 60% të mjeteve të fituara emigrantët ua dërgojnë familjarëve në vendlindje, për plotësimin e nevojave elementare jetësore dhe për nevoja të tjera.


Gjatë gjithë historisë së tyre, shqiptarët e Luginës ishin pjesë përbërëse e tërësisë etnike shqiptare, duke marrë pjesë aktive në të gjitha proceset dhe lëvizjet kombëtare e çlirimtare, politike dhe ekonomike të kombit shqiptar. Në kohën turke, Lugina ishte pjesë përbërëse e Vilajetit të Kosovës. Në periudhën e Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene (1919-1941) bënte pjesë në Banovinën e Vardarit, ndërsa pas Luftës së Dytë Botërore, në pikëpamje territoriale-administrative mbeti jashtë hapësirës së pakëputur etnike. Ndonëse në rrethana të tilla, shqiptarët e Luginës morën pjesë në mënyrë aktive në luftën e shqiptarëve të Kosovës (1998-1999) dhe në konfliktin shqiptaro-maqedon të vitit 2001. Në pikëpamje kulturore dhe shpirtërore, në rrafshin etnografik (martesat, doket, zakonet etj.) dhe në aspektin arsimor (shkollimi universitar) si në të kaluarën, ashtu edhe sot, shqiptarët e Luginës mbesin të lidhur ngushtësisht me Kosovën. (Hivzi Islami)

LUGU I BARANIT. Trevë në pjesën perëndimore të Kosovës, në kuadër të Rrafshit të Dukagjinit. Shtrihet përgjatë rrjedhjes së poshtme të Bistricës së Deçanit. Drini i Bardhë

e ndan nga Llapusha në lindje, në veri kufizohet me Lugun e Leshanit, ndërsa në jug mbyllet nga pjesa kodrinore e Dushkajës. Karakterizohet me shtrirje gjatësore prej 10 km, gjerësi mesatare 2 km dhe sipërfaqe rreth 72 km². Në përbërjen gjeologjike dominojnë formacionet e reja të pleistocenit dhe holocenit. Relievi është i valëzuar me lugje, kodrina të vogla dhe rrafshina aluviale. Lartësia mesatare mbidetare është rreth 450 m. Klima është e mesme kontinentale. Reshjet mesatare vjetore sillen rreth 850 mm. Lumi kryesor është Bistrica e Deçanit. Nga llojet e tokave dominojnë tokat smonicë, podzole dhe aluviale. Bimësia përfaqësohet nga pyjet e dushkut (55,7%), arat (25,5%), livadhet (13,3%) dhe kullostat (5,5%). Vendbanimet janë të vendosura në anën e majtë të rrafshit aluvial të Bistricës së Deçanit. Jetojnë rreth 8.300 banorë (2011) të shpërndarë në 16 vendbanime. Vendbanimet më të mëdha janë: Gllgjani, Barani, Vranoci etj. Popullsia merret kryesisht me bujqësi. (Selim Qevani)

LULAJ Shefqet (1954-). Mjek, gjinekolog-obstetër, profesor universitar. Lindi në Pejë, shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, studimet në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë (1979). Pas diplomimit zë punë në Klinikën e Gjinekologjisë dhe Obstetrikës në Prishtinë, ku njëkohësisht vijoi edhe specializimin. Studimet pasuniversitare i kreu në Fakultetin e Mjekësisë në Zagreb. Në vitin 1986 u zgjodh asistent i lëndës gjinekologji me obstetrikë në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. Për ngritje profesionale qëndroi në Bad Orb dhe Dyseldorf të Gjermanisë. U subspecializua në Universitetin e Këlnit po në Gjermani dhe u certifikua për ultratingull (1999-2000). Mbrojti temën e doktoratës në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës. Tani është profesor i rregullt i gjinekologjisë po në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. Kreu detyra me përgjegjësi dhe ushtri funksione të ndryshme në institucionet shëndetësore. Mori pjesë në shumë seminare dhe tubime shkencore nga lëmi i gjinekologjisë me obstetrikë dhe botoi shumë punime profesionale dhe shkencore brenda dhe jashtë vendit. Punoi në Klinikën Gjinekologjike më Obstetrikë dhe është profesor ordinar i lëndës së gjinekologjisë. (Ibrahim Rexhaj)

LULI Dedë Gjo (1840-1915). Prijës popullor i Malësisë së Mbishkodrës, luftëtar për pavarësinë e Shqipërisë, Heroi i Popullit. Lindi në Traboin të Hotit, sot në Mal të Zi. Që në moshë të



DEDE GJO LULI

re mori pjesë në luftërat e Malësisë së Mbishkodrës për mbrojtjen e territoreve shqiptare nga pushtimet malazeze. U përfshi në zhvillimet e luftarake të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, veçmas për mbrojtjen me sukses të Hotit dhe Grudës, kundër aneksimit të këtyre viseve nga Mali i Zi, pas vendimit të Fuqive të Mëdha. Pas shuarjes së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit më 1881, D. Gj. Luli u largua nga Hoti, për t'i shpëtuar ekspeditave ushtarake të komanduar nga Derwish Pasha dhe për tri vjet u strehua te Qerim Binak Alia i Krasniqes dhe Mehmet Shpendi i Shalës së Dukagjinit. Luftoi kundër forcave ushtarake osmane dhe sulmeve plaçkitëse të bandave malazeze gjatë viteve 1883-1887, por edhe në vitet e mëvonshme. Më vonë mori pjesë në tubimet mbështetëse të Malësisë së Mbishkodrës, për t'iu bashkëngjitur Lidhjes së Pejës. D. Gj. Luli ishte udhëheqës edhe organizator i kryengritjes së Malësisë së Mbishkodrës më 1911, kundër forcave osmane. Suksesi i kësaj kryengritjeje bëri që Perandoria Osmane të detyrohej të hynte në bisedime me shqiptarët, të cilët me Memorandumin e Greçës parashtruan kërkesë për autonomi territoriale dhe administrative. Pas shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, D. Gj. Luli, ndonëse në moshë të thyer, e vazhdoi luftën për mbrojtjen e territoreve shqiptare nga pushtimet dhe aneksimet gjatë luftërave ballkanike dhe pas tyre. Ishte njëri ndër organizatorët kryesor për mbrojtjen e Shkodrës kundër pushtimit malazias. Pas pushtimit të Shkodrës dhe reprezaljeve malaziase ndaj atyre që kishin bërë rezistencë, D. Gj. Luli u detyrua të gjente strehim në Mirditë, ku më 1915 u vra nga ushtria serbe, e ndihmuar nga forcat e Esad pashë Toptanit. (Isa Bicaj)

LUMA Ernest (1976-). Gazetar. Lindi në Gjakovë, ku kreu shkollimin fillor dhe të mesëm, ndërsa studimet për letërsi dhe gjuhë shqipe i mbaroi në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës. Shkrimet e para i botoi si gjimnazist në revistat letrare lokale. Me gaze-

tari filloi të merret nga viti 1997, në gazetën e studentëve “Bota e re”, ku ishte gazetar dhe redaktor deri në mars të vitit 1999. Ishte aktiv në lëvizjen studentore të viteve 1997-1999. Pas luftës, në vitet 2000-2001 dhe 2004-2005 ishte redaktor dhe gazetar në të përditshmen “Epo-ka e re”, pastaj kryeredaktor i agjencisë “Kosovapress”, i gazetës së përjavshme “Focus” dhe i gazetës së përditshme “Nacional” (2008). Është autor i monografisë “Drita shkëlqyese dhe hyjnore nëpër shekuj e Teqesë së Madhe Autoqefale Ballkanike” (2009). Më 2002 aderoi në Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës, ku ishte anëtar kryesie deri më 2015, kur dha dorëheqje. Shkruan edhe poezi. (Muhamet Mavraj)

LUMANI Fatos (1983-). Kompozitor. Lindi në Strugë. Shkollimin bazë muzikor e kreu në vendlindje, ndërsa studimet për kompozicion në Akademinë e Arteve në Tiranë, ku një



FATOS LUMANI

kohë punoi si asistent. Më pas ishte udhëheqës i programit studimor për artin muzikor në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Tetovës, ku ligjëroi lëndët harmoni analitike dhe analizë forme. Hapin e parë si kompozitor e bëri me veprën “Sinfonietta” (punim diplome, 2006), vazhdoi me krijimtarinë me prirje për forma të mëdha muzikore: gati gjysma e tyre për orkestër kamerale dhe simfonik. Gjuha e tij muzikore ka pamje polistilistike, me koncepte të neoklasicizmit e barokut, me teknika bashkëkohore si serializmi, aleatoria dhe përqendrim të folklori si bazë për frymëzim e trajtim të veçantë. Ndër veprat e tij janë: Suitë për orkestër (2004), Sonatë për piano (2008), Metamorphoses in D, për harqe (2012), Kantata për Kongresin e Manastirit, për solistë, kor e orkestër (2012), Koncert për piano e orkestër (2013), Tri humoreska ballkanike, për violë, violinë, obo e piano (2013). Janë luajtur në shumë festivale, disa pre tyre janë fituese çmimesh. Është anëtar i Lidhjes së Kompozitorëve e Muzikologëve të Maqedonisë. (Fatmir Hysi)

LUMEZI Lazër (1870-1941). Rilindës, veprimtar i arsimit. Lindi në Prizren, ku kreu edhe arsimin fillor. Ishte krah i djathtë i Mati Logorecit dhe mësues në shkollën laike



LAZËR LUMEZI

për themelimin e shoqërisë “Besa-Besë” të Pejës. Kontributin më të madh e dha në fushën e arsimit kombëtar, ku punoi për 40 vjet. U shqua në fushën e metodikës së mësimdhënies, si autor tekstesh shkollorë në gjuhën shqipe, të metodikës etj., ndër të cilat janë: “Abetari shqip”, “Doracak për gjuhën shqipe e serbokroate”, “Fletore e punës së Lazër Lumezit”, “Mësime përdorue prej mësuesve nëpër shkolla fillore, në klasë të parë dhe të dytën”, “Mësime të përditshme, për të dytën klasë” (në dorëshkrim), “Kënga gjithfarësh të xansa shkollët përmbledhur prej Lazer Lumezit” (1917). Në vitin 1982 u botua edhe vepra “Makaronat e shejtanit”. (Xhafer Ismajli)

LUMËBARDHI I PRIZRENIT. Lumë në pjesën jugore të Kosovës, i cili rrjedh përmes Prizrenit, prej nga e ka marrë emrin. Është dega e majtë më e rëndësishme e Drinit të



RRJEDHA E LUMBARDHIT NË PRIZREN

Bardhë. Rrjedh përgjatë maleve të Sharrit dhe pjesës jugore të Rrafshit të Dukagjinit. Ka

gjatësi 35.5 km, kurse sipërfaqen ujëmbledhëse 279 km². Prurja mesatare vjetore sillet rreth 5.26 m³/s. Lumëbardhi i Prizrenit ka dendësi të madhe të rrjetit hidrografik, në veçanti në degët e majta. Degët më të rëndësishme janë: Shartica, Petroshtica, Draçica, Lubinja, lumi i Manastirit dhe Jabllanica, kurse nga ana e djathtë nuk ka ndonjë degë të rëndësishme. Pjesa më e madhe e ujëmbledhësit i takon relievit malor (80%), kurse pjesa e poshtme (perëndimore) është kryesisht fushore. Për shkak të relievit malor dhe reshjeve të shumta, pellgu i Lumëbardhit karakterizohet me erozion shumë të madh. Në të dalë prej maleve të Sharrit kalon përgjatë qytetit të Prizrenit, duke i shtuar atij jetën dhe bukurinë. Nga burimet e këtij pellgu furnizohet me ujë qyteti i Prizrenit dhe më gjerë. Uji është përdorur edhe për ujitje në fushën e Prizrenit. Afër fshatit Muradem derdhet në Drinin e Bardhë. (Bashkim Kabashi)

LUMI Bekim (1966-). Regjisor, profesor universiteti. Lindi në Suharekë. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërkaq të mesmen në Prishtinë. Kreu studimet për letërsi dhe gjuhë



BEKIM LUMI

shqipe në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës (1991), ndërsa studimet për regji teatri i mbaroi në Fakultetin e Artit Skenik të Akademisë së Arteve të Bukura në Tiranë (1996). Më 1998, në Muni (Gjermani) themeloi Teatrin “Loja”, me të cilin e filloi punën si regjisor. Më pas vuri në skenë shfaqje në Teatrin “Dodona” dhe në Teatrin Kombëtar të Kosovës. Më 2006 themeloi dhe revistën për teatër “Loja”. Më 2009 themeloi në Prishtinë teatrin e pavarur që e pagëzoi Teatri Laborator “Loja”. Nga viti 2002 punon mësimdhënës i regjisë së teatrit në Fakultetin e Arteve (dega e artit dramatik) të Universitetit të Prishtinës. Fillimisht në Muni (Gjermani), me Teatrin “Loja” krijoi shfaqjen “Zogu i shqiptarit dhe zogu i gomarit” (1998) dhe më pas shfaqjen “Për gruan dhe tokën e jap edhe kokën” (1999), si dhe shfaqjen me kukulla “Kësulëkuqja në botën e minave” (2000). Pas kthimit në Kosovë, në Teatrin “Dodona” vuri në skenë shfaqjen “Mësimi” (2002) dhe “Galani” (2003). Vijoi

me shfaqjet në Teatrin Kombëtar të Kosovës: “Arushani & Fejesa” (2005), “Shtëpia e Bernarda Albës” (2006), “Çifti Martin” (2008), “Nana dhe fëmija” (2015). Ndërkaq në Teatrin “Loja” krijoi shfaqjet “Këmisha e gjakut” (2010), “Kanuni i Lekë Dukagjinit”, “Dilerat” (2013) dhe “John Cage’s Hamlet” (2015). Me shfaqjet e tij e ka përfaqësuar Kosovën në disa festivale teatrore ndërkombëtare, në rajon dhe më gjerë, në të cilat u nderua me çmime të ndryshme: në Festivalin Ndërkombëtar të Teatrit (2006), në Lugano (Zvicër), shfaqja “Mësimi” mori çmimin për shfaqjen më të mirë; në Festivalin Ndërkombëtar të Teatrit Kamertal në Vratza të Bullgarisë (2011), shfaqja “Çifti Martin” mori çmimin shfaqja më e mirë muzikore, ndërsa shfaqja “Këmisha e gjakut” mori mirënjohje speciale në Festivalin Ndërkombëtar të Teatrit “MESS” në Sarajevë (2012). Më 2016, për shfaqjen “John Cage’s Hamlet” nga Ministria e Kulturës së Kosovës mori çmimin vjetor për regjinë më të mirë për vitin 2015. (Fadil Hysaj)

LUMI DRENICA. Lumë në fushëgropën e Drenicës. Është dega më e gjatë nga ana e majtë e lumit Sitnica. Gjatësia 50 km, sipërfaqja e ujëmbledhësit 446.4 km², buron rrëzë malit të Carralevës, nën majën Bratanac, në lartësinë mbidetare 1,044 m. Mbledh ujërat e shpateve perëndimore dhe jugore të Çiçavicës, të anës perëndimore dhe veriore të Goleshit, të Blinajës dhe të Carralevës, të anës lindore të malit Drenica dhe Kosmaç. Vija ujëndarëse e Drenicës është 116.5 km, ndërsa gjatësia e të gjitha rrjedhave ujore është 661.1 km apo dendësi të rrjetit lumor prej 1.47 km/km². Pjesët e larta të pellgut të lumit Drenica ndërtohen nga shkëmbinjtë e moshës paleozoike (filite, shiste argjilore, rreshtet e gjelbra), mesozoike (diabazet, serpentinitet), kurse pjesët e ulëta nga sedimentet e pliocen-kuaternarit (argjilë, rërë, zhavorr). Lartësia mesatare mbidetare e pellgut është 687 m. Deri në Drenas shtrati i lumit është më i gjerë dhe me pjerrtësi të vogël me tipare të një lumi fushor, ndërsa deri në rajonin e Bellaqevcit ka krijuar luginë grykore, me thellësi dhe pjerrësi më të madhe. Derdhet në lumin Sitnica në lokalitetin Vragoli. Prurjet mesatare vjetore 1.5 m³/sek. Përdoret për ujijtjen e tokave bujqësore. (Shpejtjm Bulliqi)

LUMI I KAÇANOLLIT. Lumë në pjesën verilindore të Kosovës, në anën lindore të Shalës

së Bajgorës. Formohet me bashkimin e dy përrenjve që burojnë në shpatet lindore, përkatësisht jugore të malit Bajrak, në lartësinë mbidetare 1,600 m. Rrjedh në drejtim të jugut, duke mbledhur përrenj të shumtë nga malet e Kopaonikut, kalon përmes vendbanimit Kaçanoll, sipas të cilit ka marrë emrin. Në fshatin Luçç i Poshtëm derdhet në lumin Llap. Është lumë malor, me rënie të madhe, rrjedhje të shpejtë dhe mjaft i pasur me ujë. Sipërfaqja e pellgut 88 km², prurja mesatare vjetore 0.68m³/sek, prurja përgjithshme vjetore 21.35 mil.m³ ujë. Si i tillë ofron mundësinë e shfrytëzimit për hidroenergjia dhe akumulim të ujit. (Bektesh Vidishiqi)

LUMI I MURZHICËS. Lumë në Malet e Sharrit, në qendrën turistike Brezovica. Sipërfaqja e ujëmbledhësit është 15.8 km², kurse gjatësia 5.2 km. Burimet e lumit janë në lartësi mbidetare mbi 1,600 metra, të cilat bashkohen afër qendrës së skijimit dhe rrjedhin në drejtim të vendbanimit të Brezovicës, që pastaj të derdhet në lumin Lepenc. Është lumë malor, prurja më e madhe e ujit është gjatë muajve prill-maj, që lidhet me shkrirjen e borës në pjesët e epërme të ujëmbledhësit. Skaji jugor i ujëmbledhësit kalon përgjatë kufirit me Maqedoninë, në të cilin spikat maja më e lartë Piri Breg (2,449 m). Lugina është e ngushtë dhe e thellë, ndërsa në pjesët e larta karakterizohet me shpate të pjerrëta. Lugina është e thelluar në rreshtet e paleozoikut, gëlqerorë dhe morena. Lugina e lumit është fluvio-glaciale. (Ruzhdi Pillana)

LUMI I NERODIMES. Lumë në pjesën jugore të Fushës së Kosovës, dega kryesore e lumit Lepenc, buron nga malet e Jezercit dhe rrjedh kryesisht përgjatë maleve të Jezercit dhe të Nerodimes, ndërsa në fshatin me të njëjtin emër futet në Fushën e Kosovës. Degët kryesore janë: Lumi i Madh dhe Lumi i Vogël, të cilët bashkohen në fshatin Nerodime e Ulët dhe formojnë lumin Nerodime. Në pjesën fushore të lumit, për shkak të ujëndarësit topografik të ulët si dhe me ndërhyrjen e njeriut, në lumin Nerodime është formuar një dukuri e rrallë hidrografike – bigëzimi (bifurkacioni), ku njëra degë e lumit (e djathta) rrjedh në drejtim të Lepencit dhe shkon në detin Egje, kurse dega e majtë rrjedh në drejtim të Sitnicës dhe shkon në Detin e Zi. Sipërfaqja e pellgut të Nerodimes është 218 km², kurse gjatësia 41

km. Lugina e lumit në pjesën e sipërme është e thelluar në rreshe të permotriasikut dhe gëlqerorë, ndërsa në pjesën e poshtme është thelluar në shkëmbinj të pliocen-kuaternarit (rërë, zhavorre, sedimentet liqenore). Në pjesët burimore të ujëndarësit, lartësia mbidetare arrin në 1,721 m, kurse lartësia mesatare e pellgut është 781 m. Për shkak të lartësisë mbidetare, prurja e lumit varet më shumë nga reshjet e shiut sesa të borës (regjim pluvio-nival). Prurjen më të madhe e ka në vjeshtë dhe në pranverë. Gjatë reshjeve me intensitet të lartë, në fillim të pranverës, vërshon tokat përreth. Në Kaçanik derdhet në lumin Lepenc me një prurje mesatare vjetore prej 2.1 m³/sek. (Valbon Bytyçi)

LUMI I PLAVËS. Lumë në jug të Kosovës, në trevën e Opojës. Në pjesën e epërme njihet si lumi i Zaplluxhës. Buron në shpatet e Gurit të Zi, në lartësi mbidetare 1,400 m. Nga fshati Plavë, në rrjedhën e mëtejshme e merr emrin lumi i Plavës. Ka sipërfaqe të pellgut ujëmbledhës 257 km², gjatësi 21 km dhe prurje mesatare vjetore në dalje, në kufi me Shqipërinë, 5.2 m³/s. Në territorin e Shqipërisë njihet me emrin Lumë. Sipërfaqja e ujëmbledhësit topografik të Lumës është 365 km², gjatësia 35 km, sasia mesatare vjetore e reshjeve në pellg është 982 mm, ndërsa prurja mesatare në grykëderdhje 13 m³/s. Mbledh më tepër se 40 rrjedhje ujore të Opojës dhe Gorës. Më kryesoret janë lumi i Brodit dhe i Restelicës. Janë rrjedhje malore me potencial hidroenergetik. Në lumin Brod, degë e Plavës, është ngritur hidrocentrali "Dikanca" me kapacitet 1.12 MW. Afër Kukësit derdhet në Drinin e Bardhë. (Selim Qevani)

LUMI I PRISHTINËS. Degë e djathtë e lumit Sitnica, që formohet me bashkimin e lumit Balaj dhe atij të Qyqes afër Grashticës, 7.5 km në verilindje të Prishtinës. Lumi Prishtina deri te hekurudha në Prishtinë është i gjatë 8.4 km, ndërsa deri në grykëderdhjen e tij në Sitnicë 15.3 km. Sipërfaqja e pellgut është 106 km², me shtrirje verilindje-jugperëndim, në formë të shkronjës "S", me gjerësi mesatare prej 4.2 km. Dega e majtë më e rëndësishme e lumit të Prishtinës është përroi i Vellushës (gjatësia 3 km), i cili krijohet nga disa burime të vogla rrëzë kodrës së Butovcit (900 m lartësi), në lindje të Gërmisë. Degë tjetër e majtë është edhe përroi i Kolovicës (3.2 km), që i bashkohet

afër Prishtinës. Ndërsa afër lokalitetit Zllatar formohet përroi i Matëçanit (5.9 km), që është dega e djathtë më e rëndësishme. Përgjatë rrjedhës nëpër qytetin e Prishtinës, ky lumë është i mbuluar dhe në të derdhen ujërat e zeza. Në jugperëndim të qytetit të Fushë-Kosovës derdhet në lumin Sitnica. (Shejtim Bulliqi)

LUMI I SHTIMES. Degë e majtë e lumit Sitnica, rrjedh nga malet e Carralevës në drejtim të Fushës së Kosovës. Formohet me bashkimin e lumit Carraleva dhe Topilla në afërsi të Shtimes. Ka rrjedhje kryesisht perëndim-lindje. Gjatësia 26 km, sipërfaqja e pellgut 186 km², prurja mesatare vjetore rreth 1 m³/sek. Pellgu i lumit të Shtimes ndërtohet me shkëmbinj të fortë të moshës së kretakut (gëlqerorë, flishorë) dhe rreshpet e paleozoikut në pjesën e sipërme të tij, kurse me shkëmbinj të rinj (rërë, zhavorr etj.) në pjesën e poshtme. Në pjesën e epërme vërehen gryka lumore (gryka e Carralevës, e Topillës etj.), ndërsa në pjesën e poshtme disa meandra të vogla. Pas lumit Drenica, lumi i Shtimes është dega më e madhe e majtë e Sitnicës. Në jugperëndim të fshatit Robovc bashkohet me lumin Sitnica, ku ujërat pastaj rrjedhin në drejtim të Detit të Zi. (Valbon Bytyçi)

LUMI KLINA. Lumë në Rrafshin e Dukagjinit, degë e majtë e Drinit të Bardhë. Buron nga mali Mokna dhe rrjedh në pjesën veriore të Drenicës dhe në pjesën verilindore të Rrafshit të Dukagjinit me gjatësi 69 km. Sipërfaqja e pellgut është 439 km². Pjesa më e madhe e pellgut është e ndërtuar nga flishi i kretakut dhe nga sedimentet e pliocen-kuaternarit. Sasia mesatare e reshjeve në pellg është 666 mm. Prurja mesatare shumëvjeçare e lumit Klina është 1.5 m³/sek. dhe është një nga degët e Drinit të Bardhë me prurjen më të vogël. Maksimumi i rrjedhjes është në muajin shkurt, kurse minimumi në muajin gusht (0.3 m³/s). Degët më të rëndësishme janë Joshanica dhe Klisura. Në pjesën e poshtme, ndërmyet Gjurgjevikut dhe Klinës së bashku me degën e saj Murga (Klisura), kanë krijuar disa gryka të thella në gëlqerorë shtresëshollë. Rreth 1 km në jugperëndim të qytetit të Klinës bashkohet me Drinin e Bardhë. (Valbon Bytyçi)

LUMI LLAP. Degë e djathtë e lumit Sitnica, drenon ujërat e shpateve jugore të Kopaonikut dhe të pjesës veriore të maleve lindore të Kosovës. Për nga gjatësia e rrjedhës (76.8 km)

dhe sipërfaqja e pellgut (948.9 km²) është dega kryesore e Sitnicës. Formohet me bashkimin e lumit Murgull (buron në Shatoricë, 1,690 m) me përroin e Reçicës, afër vendbanimit Pollatë (17 km në veri të Podujevës). Rrjedha e sipërme karakterizohet me degë të shumta për shkak të karakterit malor dhe mbulueshmërisë së mirë me pyje. Në rrjedhën e poshtme lumit Llap nga ana e majtë i bashkohet rrjedha të rëndësishme: lumi i Batllavës dhe i Dumnicës, ndërsa nga ana e djathtë i bashkohet lumi i Kaçanollit. Lugina e lumit Llap në pjesën e sipërme është e ngushtë (1.5 km), ndërsa afër fshatit Bajçinë arrin gjerësinë deri në 10 km. Në pjesën e sipërme lugina është e thelluar në sedimentet flishore, në rrjedhjen e mesme në sedimentet e pliocen-kuaternarit, ndërsa në rrjedhën e poshtme, duke thelluar luginën e tij në formacionin flishor të Kulinës, lumi kalon në fushëgropën e Kosovës. Rënia e Llapit nga Pollata (746 m) deri në grykëderdhje (518 m) është 234 m (6.0%). Niveli mesatare i ujit në këtë lumë është 53 cm, ai minimal 10 cm, ndërsa ai maksimal 242 cm. Prurja mesatare 4.5 m³/s. Shfrytëzohet kryesisht për ujitje të sipërfaqeve bujqësore në fushëgropën e Llapit dhe atë të Kosovës. Lumi Llap derdhet në Sitnicë. (Shpejtim Bulliqi)

LUPÇI Beqir (1938-). Mjek, stomatolog, profesor universiteti. Lindi në Elbasan, shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në Prishtinë, studimet në Fakultetin e Stomatologjisë në



BEQIR LUPÇI

Beograd (1965). Pas diplomimit filloi punë në Poliklinikën e Dhëmbëve në Prishtinë. Specializimin nga ortopedia e nofullave dhe studimet pasuniversitare i përfundoi po në Fakultetin e Stomatologjisë në Beograd (1974), ndërsa më 1977 mbrojti tezën e doktoratës. Po këtë vit u zgjodh asistent i ortopedisë së nofullës në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë, dega e stomatologjisë, ku i arriti të gjithë titujt universitarë. Në vitin 1981 kreu subspecializimin në Spitalin Mbretëror Dentar të Londrës. Ishte i pari magjistër shqiptar dhe doktor i shkencave të stomatologjisë në Kosovë. Kreu detyra me përgjegjësi në institucionet shëndetësore dhe universitare. Është autor dhe bashkautor i shumë punimeve shkencore-profesionale të

botuara brenda dhe jashtë vendit dhe bartës i shumë mirënjohjeve. Ishte bashkautor i tekstit universitar të ortodoncisë në nivel të ish-Jugosllavisë. (Fatmir Dragidella)

LUSHTA Riza (1916-1997). Futbollist. Lindi në Mitrovicë. Hapat e parë të futbollit i nisi te rinjtë e “Rudarit” në vitin 1932. Pas dy vjetësh shkoi në Shqipëri dhe karrierën e futbollistit e bëri te skuadra e “Tiranës”, ku luajti deri në vitin 1939. Gjatë kësaj periudhe ndihmoi klubin ta fitonte katër herë titullin e kampionit, duke kontribuar me 39 gola në 69 paraqitje. Në vitin 1939 shkoi në Itali dhe firmosi me skuadrën e “Barit”, ku luajti vetëm një edicion. Në vitin 1940, Lushta bëri kalimin më të madh në karrierë, duke iu bashkuar skuadrës së madhe italiane “Juventus”. Te kjo skuadër R. Lushta regjistroi 95 paraqitje dhe shënoi 56 gola. Pas largimit nga “Juventusi”, kaloi te “Napoli” dhe më pas tek “Alessandria”, ku luajti për dy vjet. Prej vitit 1948 e deri më 1951 la futbollin italian, për të vazhduar karrierën në Francë, te skuadra “Cannes”. Në vitin 1951 u rikthye në Itali te “Siena”, kurse luajti edhe te “Forlì” e “Rapallo Ruentes”. Në vitin 1953 e la futbollin aktiv, pas një karriere të shkëlqyer (në Serinë A realizoi 68 gola në 170 ndeshje të zhvilluara). Në moshën 80-vjeçare R. Lushta ndërroi jetë në Torino. Emrin e tij e mban stadiumi i skuadrës “Trepça ‘89” në Mitrovicë. (Arsim Maxhera)

LUSHTAKU Ilir (1971-1999). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), dëshmor. Lindi në fshatin Prekaz i Poshtëm, komuna e Skënderajt. Njihej për se afërmi me pjesëtarët e grupeve dhe celulave të para të luftës çlirimtare në Kosovë. Gjatë zhvillimit të betejës së Klysyres, më 26 nëntor 1997, me urdhër të komandantit Adem Jashari ishte pjesë e grupit të luftëtarëve që bllokuan aksin rrugor Skënderaj-Drenas, afër fabrikës së vjetër të tjegullave. Ishte pjesëmarrës në luftimet e Likoshanit dhe të Qirezit (28 shkurt 1998). Në kuadër të Brigadës 114 “Fehmi Lladrovci” ka qenë pjesëmarrës në një sërë aksionesh. Ra heroikisht në fshatin e tij të lindjes në Prekaz të Poshtëm, më 26 mars 1999. (Sabit Sylja)

LUSHTAKU Mirsad (1977-). Grafist. Lindi në Skënderaj. Shkollën fillore e kreu në Prekaz, ndërsa të mesmen në Skënderaj, Fakultetin e Arteve Figurative, drejtimin e grafikës, e kreu

në Prishtinë (2001). Në vitin 2006 u zgjodh asistent i grafikës, ndërsa më vonë mori titullin përkatës universitar në Fakultetin e Arteve. Ka punuar disa skenografi për filma të metrazhit të shkurtër dhe ka hapur ekspozita personale të “Hani i 2 Robertëve” në Prishtinë dhe në Galerinë Kombëtare në Shkup. Është pjesëmarrës në disa ekspozita kolektive të organizuara nga Shoqata e Artistëve Figurativë të Kosovës dhe ka marrë çmime për grafikë nga kjo shoqatë më 2001 e 2005. (Basri Mekolli)

LUSHTAKU Nuredin (1967-). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Lindi në fshatin Prekaz i Poshtëm i komunës së Skënderajt. Bënte pjesë në grupet e para guerile të luftës çlirimtare në Kosovë në vitet 1992-93. Mori pjesë në disa aksione kundër forcave serbe, të organizuara nga grupi i Adem Jasharit. Në korrik të vitit 1997 Gjykata serbe e Prishtinës e dënoi në mungesë me 20 vjet burg. Në tetor të vitit 1997 mori pjesë në aksionin kundër policisë serbe në Drenas. Në nëntor të vitit 1997 ndërmori një aksion tjetër kundër stacionit policor serb në Runik të Skënderajt. Më 26 nëntor 1997, atë ditë që u zhvillua beteja në Klysyre, me urdhër të komandantit Adem Jashari kishte bllokuar aksin rrugor Skënderaj-Drenas, afër fabrikës së vjetër të tjegullave. Ishte pjesëmarrës në luftimet e Likoshanit dhe të Qirezit (28 shkurt 1998), përkrah Adem Jasharit dhe bashkëluftëtarëve të tjerë të UÇK-së. Në luftën e Jasharëve në mars të vitit 1998 luftoi kundër forcave serbe nga lagja e Lushtakëve. Më pas ishte pjesëmarrës i disa betejave dhe aksioneve në Zonën Operative të Drenicës dhe në Zonën Operative të Shalës. Fillimisht ishte komandant i batalionit III të Brigadës 114 “Fehmi Lladrovci”, ndërsa më vonë u zgjodh anëtar i shtabit të Zonës Operative të Drenicës. Pas rënies së Iliaz Kodrës u emërua komandant i Brigadës 114 “Fehmi Lladrovci”. Pas luftës ishte komandant i Gardës së Kosovës deri në vitin 2008. Në qershor 2014 u zgjodh deputet i Partisë Demokratike të Kosovës në Kuvendin e Kosovës. (Sabit Sylja)

LUSHTAKU Sami (1961-). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Lindi në Prekaz të Poshtëm, komuna e Skënderajt. Ishte pjesë e grupeve të para guerile të luftës çlirimtare në Kosovë dhe pjesëmarrës në aksionet e para të armatosura ndaj forcave policore serbe (1992/93). Shërbimi sekret serb i kishte rënë

në gjurmë veprimtarisë e tij, prandaj Gjykata serbe e Prishtinës në korrik të vitit 1997 e dënoi në mungesë me 20 vjet heqje lirie. Për shkak të përndjekjeve të vazhdueshme, u detyrua të emigrojë Gjermani, ku qëndroi nga viti 1993 deri në mars të vitit 1998. Edhe në Gjermani vazhdoi aktivitetin politik në kuadër të Lëvizjes Popullore të Kosovës. Në mars të vitit 1998 u kthye në Shqipëri dhe me një grup prej 70 luftëtarësh kaloi në Kosovë. Më 25 mars 1998 është plagosur në Krushë të Madhe, duke bartur armatim për UÇK-në nga Shqipëria. Në Zonën Operative të Drenicës fillimisht ishte zëvendëskomandant, ndërsa në fillim të vitit 1999 u emërua komandant i kësaj zone. Mori pjesë në luftimet e zhvilluara në grykën e Llapushnikut, të Rrasa e Rahovecit, në Rrezallë, Shtuticë etj. Pas luftës, pas demilitarizimit të UÇK-së (1999), u emërua në poste të ndryshme në Trupat Mbrojtëse të Kosovës (TMK). Në zgjedhjet lokale të vitit 2007 u zgjodh kryetar i komunës së Skënderajt, për të vazhduar në këtë post edhe në dy mandatet vijuese. (Sabit Sylja)

LUTFIU Ibrahim (1913-1950). Veprimtar i lëvizjes antikomuniste dhe nacionaliste shqiptare, gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore. Lindi në Prizren. Familja e tij kishte zbritur nga Opoja. Në Prizren kreu shkollën fillore dhe gjimnazin më 1933. Pasi siguroi një bursë nga Bashkësia Islame, regjistroi studimet në Beograd në Fakultetin Juridik, të cilin e kreu më 1938. Më 1939 u punësua në Bashkësinë Islame të Sarajevës, sekretar për Kosovë. Më 1941 u kthye në Mitrovicë, ku u emërua nën-prefekt. Më 1943 mori pjesë në Qeverinë e Tiranës. Më 1944, në fund të nëntorit, u kap nga organet e OZN-ës në afërsi të Rahovecit. Disa ditë më vonë, në rrugë për Prishtinë e lirojnë kryengritësit e Adem Gllavicës. Me kërkesën e tij dërgohet në fshatin Budakovë. Që andej mban lidhje me Lëvizjen Nacional-Demokratike Shqiptare (LNDSH). Mori pjesë në Kongresin e LNDSH-së në Blinajë më 1946, me pseudonimin Bajrami. Jetoj në ilegalitet në fshatin Budakovë deri në janar të vitit 1950, kur zbulohet nga organet e OZN-ës dhe, për të mos rënë në dorë, bëri vetëvrasje. (Liman Rushiti).

LUTOLLI Besim (1968-2010). Grafist. Lindi në Prishtinë. Kreu Fakultetin e Arteve Figurative, drejtimin e grafikës. Pas diplomimit u mor kryesisht me pikturë. Hapi disa ekspozita

personale në Prishtinë, në Pejë dhe dy në Gjermani. Një ekspozitë e tij u organizua pas vdekjes në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës. Ishte pjesëmarrës në shumë ekspozita kolektive brenda dhe jashtë vendit. Ka punuar skenografi për shfaqje teatrale në Kosovë dhe shkroi skenarë për disa filma artistikë të metrazhit të shkurtër të xhiruar në Kosovë, Maqedoni dhe në Francë. Pikturat e tij gjenden te koleksionues të artit në Francë, Japoni, SHBA, Gjermani, Holandë, Norvegji, Angli etj. (Basri Mekolli)

LUTOLLI Salih (1951-) Grafist dhe dizajner grafik. Lindi në Llapashticë të Epërme të Podujevës. Kreu Fakultetin e Arteve, drejtimi i grafikës, në Prishtinë (1986). Është anëtar i Shoqatës së Artistëve Figurativë të Kosovës, i Organizatës Kombëtare të Piktoreve të Suedisë (KRO), i Asociacionit Ndërkombëtar të Artit (IAA, UNESCO) dhe i Qendrës së Piktoreve të Suedisë Jugore (KC Syd). Ka hapur ekspozita personale në Prishtinë, në Pejë, në Tollmin dhe Kranj (Slloveni), pastaj në Bruksel, Ulqin, Chennevières sur Marne (Francë) si dhe në Malmö, Växjö dhe Perstorp (Suedi). Është pjesëmarrës në shumë ekspozita kolektive në Kosovë, Beograd, Paris, Barcelonë, Alvesta dhe Hassleholm (Suedi). Mori disa çmime profesionale, midis të cilave dhe medaljen e argjendtë për pllakat në Takimet XIX të Gazetarëve dhe Grafistëve të ish-Jugosllavisë (1986). Merret kryesisht me pikturë dhe vizatim. Jeton dhe vepron në Suedi. (Basri Mekolli)

LUZHA Asim (1890-1945). Hoxhë, veprimtar politik. Lindi në Gjakovë, ku kreu arsimin fillor, ndërsa Medresenë e kreu në Shkup dhe në Gjakovë. Shërbeu si imam në disa fshatra të Gjakovës dhe më pas në Xhaminë e Islam Begut të qytetit të Gjakovës. Midis dy luftërave botërore u shqua për angazhimet e tij në organizatën politike "Xhemijeti". Në vitin 1938 u zgjodh deputet i rrethit të Drenicës në parlamentin e Jugosllavisë. Gjatë Luftës së Dytë Botërore u inkuadrua në Luftën Nacionalçlirimtare. Në vitin 1945, ndërsa zhvillohej lufta e Drenicës e udhëhequr nga Shaban Polluzha, me porosi të Komandës së Shtabit Ushtarak, bashkë me një grup shqiptarësh me ndikim dërgohet me detyrën për t'i bindur luftëtarët që t'i ndalnin luftimet. A. Luzha arriti marrëveshje, por ajo nuk u pranua nga shtabi i Brigadës Partizane të Bokës, e cila ishte vendosur në fshatin Tërstenik.

Në natën ndërmjet 30 dhe 31 janarit të vitit 1945, A. Luzha dhe ndërmjetësit e tjerë shqiptarë u pushkatuan. U varros në fshatin Tërstenik dhe më pas u rivarros në Gjakovë. (Arbër Salihu)

LUZHA Blerim(1937-). Artist aplikativ. Lindi në Tiranë. Pas shkollës fillore në Gjakovë dhe Shkollës së Mesme të Artit në Pejë kreu studimet në Akademinë e Arteve Aplikative (drejtimi i dizajnit të tekstileve) në Beograd në vitin 1963, ndërsa studimet pasuniversitare në Shkollën e Lartë Kombëtare të Arteve Dekorative në Paris në vitin 1966 dhe u specializua në Atelienë "Opera Dessins" (1966). Në fillim punoi në Kombinatin e Tekstileve "Emin Duraku" në Gjakovë dhe në Shkollën e Artit në Pejë (1967-1970) dhe më pas në Bashkësinë Krahinore të Kulturës në Prishtinë, si bashkëpunëtor profesional për krijimtarinë artistike (1970-1986). Më pastaj gjatë viteve 1986-2003 ishte bashkëpunëtor profesional për artet aplikative në Galerinë e Arteve të Kosovës. Ka marrë pjesë në shumë ekspozita kolektive që janë organizuar nga artistë figurativë dhe aplikativë të Kosovës brenda dhe jashtë vendit dhe ka hapur disa ekspozita personale: në Gjakovë (1964), në Prizren (1967), në Tiranë(1976), në Beograd (1984) dhe në Prishtinë (1989). Në fushën e dizajnit të tekstileve është veçuar për artikullimin e elementeve etnografike shqiptare të kombinuar me florën e Kosovës. Merret edhe me dizajn grafik dhe qeramikë. Është autor i një sërë shkrimesh për artet pamore. (Rexhep Goçi)

LUZHA Murteza (1927-). Filozof, profesor universiteti. Lindi në Gjakovë, shkollën fillore e kreu në vendlindje, kurse gjimnazin në Prishtinë dhe shkollën normale përsëri në Gjakovë. Në vitin shkollor 1947/48 u angazhua në cilësinë e profesorit, në progjmnazin shqiptar në Mitrovicë. Pas përfundimit të studimeve për filozofi në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Beogradit, u punësua në gjimnazin dhe shkollën normale të Mitrovicës, e pastaj në gjimnazin dhe shkollën normale të Prishtinës. Në vitin 1959 kaloi në Radio-Prishtinë, si gazetar, përkthyes, redaktor i programit kulturor-arsimor dhe zëvendëskryeredaktor. Nga viti 1974 u angazhua në procesin mësimor në Universitetin e Prishtinës për lëndë nga filozofia dhe sociologjia, në Fakultetin e Mjekësisë dhe në katedrën filozofi-sociologji. Në vitin 1977 doktoroi në Universitetin e

Zagrebit. Përveç punës mësimore, kreu edhe detyra dhe funksione në institucionet e arsimit të lartë të Kosovës. Është autor i veprave “Shqyrtime filozofike” (1981), “Krijuesit e magjepsur të filozofisë” (2007) dhe përkthyes në gjuhën shqipe i disa librave filozofikë. (Albulena Alushaj)

LUZHA Qamil (1892-1988). Mësues, veprimtar. Lindi në Gjakovë, arsimin fillor e mori në vendlindje, ndërsa medresenë e kreu në Shkup, ku mori pjesë në mënyrë aktive në punën e shoqërisë “Xhemieti” (Bashkimi). Në vitin 1921 shkoi në Prizren, ku bashkëpunoi me Haxhi Ymer Paçarizin. Një vit më vonë shkoi në Krumë të Hasit, si mësues në shkollën

“Kosova”. Iu bashkua shoqërisë “Bashkimi” të Avni Rustemit dhe mori pjesë në Revolucionin e Qershorit të vitit 1924. Më pas punoi si mësues në Erbele, Grevë e Dibër, pastaj kryetar komune në disa rajone të Shqipërisë. Më 1942 emërohet nënprefekt në Istog, ku dha kontribut të çmuar për hapjen e shkollave shqipe. Ndërkohë, iu bashkua Lëvizjes Antifashiste, ishte pjesëmarrës në Konferencën e Bujanit dhe nënshkrues i Rezolutës së saj. Pas Luftës së Dytë Botërore u zgjodh kryetar i Këshillit të Rrethit të Gjakovës. Në vitin 1947 u burgos dhe u internua për shtatë vjet në Oseçinë të Valevës (Serbi). U dekorua nga presidenti i Shqipërisë për merita në fushën e arsimit. (Jusuf Meqa)

LL

LLADROVCI Fehmi (1956-1998). Veprimtar i Lëvizjes Popullore të Kosovës, luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Hero i Kosovës. Lindi në fshatin Shkabë (ish-Gllanasellë) të Drenasit.



FEHMI LLADROVCI

Pasi kreu shkollën e mesme u diplomua në Fakultetin e Makinerisë në Zagreb. Që në moshë të re filloi aktivitetin politik. Në prill të vitit 1985 u caktua sekretar për çështje ushtarake në Lëvizjen Popullore për Republikën e Kosovës. Në nëntor të po atij viti u arrestua dhe u dënua me 10 vjet burg. Në qershor të vitit 1990 u lirua nga burgju, pas amnistisë në Kroaci. Jetoi pak kohë në Kosovë dhe më pas u largua jashtë vendit. Së bashku me bashkëshorten dhe bashkëluftëtaren Xhevë (Krasniqi) Lladrovci mori pjesë në luftën e Kroacisë. Ishte një nga figurat kryesore të Lëvizjes Popullore të Kosovës, që u angazhuan për formimin e njësiteve të para të UÇK-së. Pas shpërthimit të luftës në Kosovë, në maj të vitit 1997, bashkë me një grup bashkëluftëtarësh u kthye në Kosovë. Ishte pjesëmarrës në të gjitha luftimet që u zhvilluan në Drenicë dhe në rajone të tjera të Kosovës. U emërua komandant i Brigadës 114 të UÇK-së. Në korrik dhe shtator të vitit 1998 forcat ushtarake-policore serbe ndërmorën ofensiva të njëpasnjëshme kundër rezistencës në zonat e çliruara në tërë Drenicën. F. Lladrovci ra në betejën e 22 shtatorit të vitit 1998, në Gradinë të Shkabajve, bashkë me Xhevën, bashkëshorten dhe bashkëluftëtaren e pandashme. Pas rënies Brigada 114 e UÇK-së mori emrin e tij. Më 2008 presidenti i Republikës së Kosovës e dekoroi F.Lladrovcin me Urdhrin “Hero i Kosovës”; më 2014, në 16-vjetorin e

rënies, Kroacia e nderoi me “Medaljen e Artë” familjen Lladrovci, për kontributin e dhënë në çlirimin e këtij vendi; ndërsa më 13 shkurt 2015 presidenti i Republikës së Shqipërisë e dekoroi me Urdhrin “Nderi i Kombit”. (Sylë Ukshini)

LLADROVCI Ramiz (1966-). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Lindi në Gllanasellë të Drenasit. Ndoqi studimet në Fakultetin e Bujqësisë të Universitetit të Prishtinës. Në vitet 1990-1993 u angazhua në degën e Drenasit të Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut. Në vitin 1993 emigroi në Gjermani, ku e vazhdoi aktivitetin në radhët e Lëvizjes Popullore të Kosovës. Nga janari i vitit 1999 ishte ngarkuar në detyrën e drejtorit administrativ të Fondit “Vendlindja thërret”. Ishte njëri nga pjesëtarët e grupeve të para të armatosura të UÇK-së, ndërsa gjatë viteve 1994-1999 u caktua përgjegjës për mobilizimin e luftëtarëve të rinj në UÇK. Pas luftës dhe demobilizimit të UÇK-së kreu detyra me përgjegjësi në Trupat Mbrojtëse të Kosovës (TMK). Pas largimit nga TMK-ja, iu rikthye aktivitetit politik në radhët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK). Në vitet 2003-2008 ishte sekretar organizativ i AAK-së, më pas u angazhua në PDK dhe në vitin 2011 u zgjodh deputet i Kuvendit të Kosovës nga radhët e kësaj partie. Në vitin 2014 u emërua i Ngarkuar me Punë në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Tiranë dhe më 2016 ambasadori i Republikës së Kosovës në Tiranë. Në dhjetor 2016 u zgjodh kryetar i komunës së Drenasit. (Ernest Luma)

LLADROVCI Sabit (1960-). Veprimtar politik, luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Lindi në fshatin Gllanasellë (Shkabaj) të komunës së Drenasit. Në vitin 1993 filloi

aktivitetin kundër regjimit okupues serb në rajonin e Drenicës. Në fillim të vitit 1998 mori pjesë në luftimet e drejtpërdrejta kundër forcave policore serbe në fshatin Likoshan, ku edhe u plagos rëndë. Pas shërimit iu ribashkua radhëve të UÇK-së në Abri. Në maj të vitit 1998 ishte pjesëmarrës në betejën në grykë të Llapushnikut, ndërsa në qershor mori pjesë në luftime në Bardhin e Madh. Më pas u emërua komandant i batalionit I të Brigadës “Fehmi Lladrovci”. Në dhjetor të vitit 1998, me urdhër të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së udhëhoqi sulmin kundër bazës ushtarake të “Feronikelit” në Drenas. Pas luftës u angazhua në radhët e Trupave Mbrojtëse të Kosovës. (Bedri Muhadri)

LLADROVCI (KRASNIQI) Xhevë (1955-1998). Veprimtare e çështjes kombëtare, luftëtare e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Heroinë e Kosovës. Lindi në Drenoc të Mali-



XHEVË LLADROVCI

shevës. Pas shkollës së mesme kreu Fakultetin Juridik dhe studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Universitetin e Prishtinës. Pas studimeve punoi në shkollën e mesme të Kijevës. Gjatë veprimtarisë ilegale, pas vitit 1981, u njoh me Fehmi Lladrovcin, me të cilin më 1991 u shpërngul në Kroaci. Ishin pjesëmarrës aktivë në luftën e Kroacisë. Në vitin 1993 emigroi në Gjermani, ku vazhdoi veprimtarinë politike në kuadrin e Lëvizjes Popullore të Kosovës (LPK). Në vitin 1977, së bashku me Fehmiun, u kthye në Kosovë, duke kontribuar në masivizimin dhe konsolidimin e UÇK-së. U shqua për organizimin e aksioneve dhe të betejave kundër forcave serbe dhe u bë oficerja e parë që ligjëroi në shkollën e oficerëve të UÇK-së në Likoc të Drenicës. Më 22 shtator 1998, kur forcat serbe ndërmoren një ofensivë kundër pozicioneve të UÇK-së në tërë Kosovën, Xh. Lladrovci, bashkë me Fehmiun dhe luftëtarë të tjerë të Brigadës 114 bënë rezistencë të vendosur. Pas shumë orë luftimesh, po atë ditë, në Gradinë të Shkabajve ra në betejë bashkë me bashkëshortin dhe bashkëluftëtarin e saj, F. Lladrovcin. Në vitin 2008 nga presidenti i Kosovës u dekorua me Urdhrin “Heroinë e Kosovës”, ndërsa më 2015 presidenti i Shqipërisë e dekoroi me titullin

“Nderi i Kombit” për kontribute të veçanta në luftën për pavarësi të Kosovës. (Sylë Ukshini)

LLAGAMI (Bardhyl) Skerdilajd (1969-2001). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), dëshmor. Lindi në Tiranë. Ishte efektiv i forcave speciale të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Shqipërisë. Në mars të vitit 1999 u bashkohet radhëve të UÇK-së në Tropojë dhe u bë pjesë e Brigadës 138 “Agim Ramadani”. Mori pjesë në Operacionin “Shigjeta” dhe, me mbarimin e luftës u sistemua në Trupat Mbrojtëse të Kosovës në Gjakovë. Më pas u angazhua në luftën e shqiptarëve në Maqedoni, në radhët e Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare. Iu bashkua forcave që vepronin në malet e Sharrit, mbi Tetovë, me detyrën e komandantit të njësitit special. Mori pjesë në shumë aksione kundër policisë dhe ushtrisë maqedonase. Në një prej këtyre aksioneve, në 29 qershor 2001 u vra në fshatin Begovi, në afërsi të Tetovës. Në vitin 2006 u rivarros në Varrezat e Dëshmorëve të Kombit në Tiranë. (Dilaver Goxhaj)

LLALLOSHI Gani (1965-). Pikturor. Lindi në Prishtinë. Shkollimin fillor, të mesëm dhe Akademinë e Arteve, drejtimin e pikturës, i kreu në Prishtinë (1989), ndërsa studimet pa-



GANI LLALLOSHI

suniversitare në Akademinë e Arteve Figurative në Lubjanë, pikturën më 1991 dhe grafikën më 1993. Si bursist i një fondacioni dhe i qeverisë gjermane, studioi në Universitetin e Artit në Berlin (1997-1998). Me Shoqatën e Artistëve Figurativë të Kosovës dhe atë të Sllovenisë mori pjesë në ekspozita kolektive në Kosovë, Slloveni dhe në disa shtete të Europës. Hapi disa ekspozita personale, si në Piran, Maribor, Shkofia-Lloka, Kranj, Umag, Izola, Kopër, Pula, Berlin, Prishtinë dhe disa herë në Lubjanë. Me forma reale e abstrakte, me elemente të qilimave klasikë ndërtoi strukturën pikturore në frymë impresionizmi, duke i lidhur dy qasje artistike, simbolikën e traditës me vizionin bashkëkohor. Për punë krijuese u shpërblye disa herë në Kosovë dhe Slloveni. Jeton dhe vepron në Piran të Sllovenisë. (Rexhep Goçi)

suniversitare në Akademinë e Arteve Figurative në Lubjanë, pikturën më 1991 dhe grafikën më 1993. Si bursist i një fondacioni dhe i qeverisë gjermane, studioi në Universitetin e Artit në Berlin (1997-1998). Me Shoqatën e Artistëve Figurativë të Kosovës dhe atë të Sllovenisë mori pjesë në ekspozita kolektive në Kosovë, Slloveni dhe në disa shtete të Europës. Hapi disa ekspozita personale, si në Piran, Maribor, Shkofia-Lloka, Kranj, Umag, Izola, Kopër, Pula, Berlin, Prishtinë dhe disa herë në Lubjanë. Me forma reale e abstrakte, me elemente të qilimave klasikë ndërtoi strukturën pikturore në frymë impresionizmi, duke i lidhur dy qasje artistike, simbolikën e traditës me vizionin bashkëkohor. Për punë krijuese u shpërblye disa herë në Kosovë dhe Slloveni. Jeton dhe vepron në Piran të Sllovenisë. (Rexhep Goçi)

LLAPASHTICA E EPËRME. Fshat në komunën e Podujevës, rreth 5 km në perëndim të qytetit. Sipërfaqja e territorit të fshatit është 2,060 ha. Gjetjet arkeologjike të kulturës materiale dhe toponimet dëshmojnë për vjetërsinë e vendbanimit. Si vendbanim me 38 shtëpi përmendet në defterin kadastral të vilajetit Vëllk të vitit 1455. Sipas regjistrimit të vitit 1981, fshati kishte 241 shtëpi me 2,013 banorë, ndërsa në vitet 1998-1999 fshati kishte 234 shtëpi me 2,460 banorë. Popullsia merret me bujqësi, blegtori, pylltari etj. Nga objektet e standardit shoqëror, fshati ka shkollën fillore, bibliotekën, stacionin shëndetësor etj. (Skender Halimi)

LLAPI. Trevë etnogeografike në pjesën verilindore të Kosovës. Shtrihet ndërmjet malit të Kopaonikut në veriperëndim, maleve të Prugocit dhe Gollakut në lindje dhe juglindje. Karakterizohet me pozitë të favorshme komunikative, sepse nëpër këtë trevë kanë kaluar rrugët kryesore të Gadishullit Ballkanik, që lidhnin Adriatikon me brendësinë kontinentale. Llapi është një fushëgropë tektonike, me shtrirje veri-jug, të ulur përgjatë thyerjeve tektonike meridionale. Gjatësia është rreth 45 km, gjerësia 6-20 km, kurse lartësia mbidetare nga 554 m deri 1,700 m. Pjesa qendrore e Llapit paraqet trevën e rrafshët me gjatësi rreth 25 km nga lokalitetet Rep-Metehi deri te gryka tërthore e Lebanës, ndërsa gjerësi prej 4-14 km. Ana lindore shtrihet në malet lindore të Kosovës me lartësi prej 700-1,000 m, ndërsa ana perëndimore në malet e Kopaonikut që karakterizohen me një relief më të shprehur. Llapi si për nga gjeneza, ashtu edhe për nga ndërtimi gjeologjik dhe lartësia mbidetare, i ngjan fushëgropës së Kosovës. Pjesët anësore kodrinore të fushëgropës së Llapit përbëhen kryesisht nga shkëmbinjtë terrigenë të kretakut të poshtëm, ndërsa pjesa fushore nga zhavorret, rërat e argjilat e pliocenit, sedimentet aluviale dhe nga tarracat e kuaternarit. Klima është mesatare kontinentale, me dimra te ftohtë me temperaturë rreth -2.4°C dhe vera të nxehta, me temperaturë 20.4°C. Pjesët anësore të fushëgropës janë të mbuluar me pyje të dushkut, të ahut dhe të halorëve, ndërsa pjesa fushore me bimësi të kultivuar. Qendër e vetme urbane e Llapit është Podujeva. (Shpejtim Bulliqi)

LLAPIT (E FOLMJA E). Bën pjesë në grupin e të folmeve të gegërishtes verilindore. Pak

elemente të ndryshme nga të folmet e tjera e bëjnë të folme më vete. Njeh tri gjatësi zanoresh të theksuara, ndërkohë që të gjatat hyjnë në raporte kundërvënese me të shkurtrat. Mungon ë-ja e theksuar, ndërsa fonema *o* realizohet si *ö: pö, jö*. Tipari më qenësor i kësaj të folmeje lidhet me numrin e vogël të fonemave zanore që krijojnë raporte opozicionale. Përgjithësisht, në këtë të folme, zanoret edhe në pozitë para bashkëtingëlloreve hundore dalin me intensitet më të vogël hundorësie sesa në të folmet e tjera të gegërishtes verilindore. Ky tipar ka vlerë fonologjike vetëm për dy fonema: *a* dhe *e*. Fonemat e tjera zanore në këtë pozitë nazalizohen pjesërisht. *I*-ja e gjatë e theksuar ka dhënë zanoren *ê: m'û shtrê*. Diftongjet *ue, ie* dhe *ye* janë shndërruar në togje zanoresh, ndërkohë në këtë të folme vërehet tendenca e labializimit të zanoreve. Edhe grupet e bashkëtingëlloreve: *mb, nd* dhe *ng* janë reduktuar në elementin e parë, ndërsa opozicioni midis palataleve dhe afrikateve është zhdukur tërësisht. Ruhët kundërvënia midis fonemave dridhëse *r* dhe *R*. Koha e pakryer e foljeve formohet nga tema e pjesores me mbaresat *-shna (-jshna)* për vetën e parë njëjës dhe *-ke (-jke)* për vetën e tretë njëjës. Krahina e Llapit shtrihet në anën veriperëndimore të Republikës së Kosovës dhe përbëhet nga fushëgropa e Llapit, në të cilën bëjnë pjesë 78 vendbanime. (Haki Hysenaj)

LLAPUSHA. Trevë kodrinore-malore në pjesën lindore të Rrafshit të Dukagjinit. Shtrihet ndërmjet lumit Klina, Drin dhe maleve Milanovc, Kosmaç dhe Gradinë. Kryesisht zë pellgun e lumit Mirusha. Llapusha ka pozitë të mirë gjeografike, duke mundësuar lidhjen me rrugë automobilistike dhe hekurudhore në mes Rrafshit të Kosovës me Rrafshin e Dukagjinit. Në aspektin gjeotektonik paraqet një strukturë grabenore, pjesën më të madhe të së cilës e ndërtojnë shkëmbinjtë e moshës së kretakut (gëlqerorë, flishorë, ranorë etj.) dhe pliocen-kuaternarit (argjilë, rërë, zhavorr etj.). Hasen edhe formacione të jurasikut (ultrabazikë, seria vullkanike-sedimentare etj.). Relievi pjerrësohet në drejtim të lumit Mirusha. Hasen edhe forma të relievit karstik. Në raport me pjesët e tjera të Dukagjinit, Llapusha karakterizohet me klimë më të thatë (reshjet mesatare vjetore deri 700 mm, ndërsa temperatura mesatare vjetore 9-10°C). Si pasojë e ndërtimit gjeologjik dhe kushteve

klimatike, Llapusha është e varfër me rrjedha ujore. Në këtë trevë paraqitet burimi i fuqishëm termomineral i Banjës së Malishevës. Lumi kryesor është Mirusha, ujërat e së cilës derdhen në Drinin e Bardhë. Pjesa më e madhe e popullsisë së Llapushës është e vendosur në vendbanimet rurale. Në skajet e kësaj treve janë të vendosura dy qendra urbane, Malisheva dhe Klina. (Valbon Bytyçi)

LLAPUSHNIKU. Fshat në Drenicë, rreth 10 km në jugperëndim të Drenasit, në lartësi mbidetare rreth 650 m. Është vendbanim i tipit të shpërndarë, me sipërfaqe 1,522 ha. Shtrihet në anën e majtë të lumit Drenica, pranë autostradës Prishtinë-Prizren-Tiranë. Si vendbanim është i regjistruar në një hartë austriake të vitit 1689 me emrin Lapushnik. Në vitin 1921 kishte 590 banorë, në vitin 1948 numëronte 942 banorë, ndërsa në regjistrimin e fundit të vitit 2011 kishte 3,433 banorë. Popullsia merret kryesisht me bujqësi (kultivimin e drithërave) dhe blegtori. Ka shkollë 9-vjeçare, disa njësi tregtare e zejtare etj. Është pjesë e bashkësisë lokale të fshatit Arllat. (Ramiz Cërvadiku)

LLATIN. Emërtim i përdorur nga besimtarët myslimanë në Kosovë për shqiptarët dhe kroatët e besimit katolik të vendit. Besohet të jetë formuar pas islamizimit të shqiptarëve nga Perandoria Osmane. Sado që ky emërtim mund të ketë marrë konotacion negativ në disa zona, vërehet se bëhet fjalë për një trashëgimi historike të emërtimit. Meqë krishterimi në Ballkan dhe më gjerë është përhapur nëpërmjet Perandorisë Romake, që si gjuhë të veten e kishte latinishten dhe e cila ishte edhe gjuhë e kishës katolike romake, fjala llatin vjen si emërtim i gjuhës së predikuar në kishë. Tek arbëreshët e Italisë dhe tek arbneshët e Zarës ka kuptimin e italianëve, përkatësisht kroatëve. (Ganimet Klaiqi)

LLESHI Bosilka (Bosiljka) (1938-). Mjeko, interniste, diabetologe. Lindi në Bosanski Shamac (B e H). Kreu shkollimin në vendlindje, ndërsa studimet e larta në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Beogradit (1964). Pas diplomimit, një kohë punoi në Shtëpinë e Shëndetit në Prizren, kurse më vonë kaloi në Klinikën për Sëmundje të Brendshme në Prishtinë. Specializoi për mjekësi interne dhe subspecializoi endokrinologjinë dhe ishte dia-

betologe e njohur. Mbrojti tezën e disertacionit në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë (1984). Ka qenë shefe reparti e diabetologjisë në departamentin e endokrinologjisë në Klinikën e Sëmundjeve të Brendshme. Publikoi një numër punimesh profesionale dhe shkencore brenda dhe jashtë vendit. (Ahmet Brovina)

LLESHI Qazim (1930-2008). Gjeograf, profesor universiteti. Lindi në Gjakovë, ku kreu shkollimin e mesëm, ndërsa shkollën e lartë pedagogjike për gjeografi e kreu në Universitetin e Beogradit (1950). Disa vjet punoi në Rahovec dhe në Gjakovë, më pas vazhdoi studimet po për gjeografi në Universitetin e Beogradit, ku u diplomua më 1959. Studimet pasuniversitare i kreu në Universitetin e Zagrebit, ku më pas mori edhe gradën doktor i shkencave gjeografike (1972). Punoi në Sekretariatit për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor të Kosovës në Prishtinë. Në Liezh dhe Bruksel të Belgjikës bëri studime të specializuara në fushën e racionalizimit (1965-1966). U zgjodh ligjërues në seksionin e gjeografisë të Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore të Universitetit të Prishtinës (1969), ku për shumë vite mbajti ligjërata për ekologji humane, gjeografi ekonomike dhe rajonale. Mori pjesë në kongrese, simpoziume, konferenca dhe seminare edhe me karakter ndërkombëtar. Botoi shumë studime nga fusha e gjeografisë rajonale dhe urbanologjisë. U mor edhe me terminologji gjeografike, toponimi dhe me publicistikë. Botoi disa vepra nga fusha profesionale-shkencore: “Qytetet e Kosovës” (1979), “Bazat e urbanologjisë” (1983), “Ekologjia humane me bazat e shkencave rrethimore” (1985), “Plava dhe Gucia qytetëza rrëzë bjeshkore” (1991). (Nesim Vala)

LLESHI Zija (1938-). Fizikan, profesor universiteti. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Gjakovë, ndërsa studimet në katedrën për fizikë teknike në Universitetin e Lubjanës (1968). Kreu studimet pasuniversitare në fushën e fizikës atomike dhe nukleare po ashtu në Universitetin e Lubjanës. Tezën e doktoraturës e punoi në Universitetin e Pragës dhe e mbrojti në Universitetin e Prishtinës (UP) në vitin 1981.



ZIJA LLESHI

Që nga vitit akademik 1982 ligjëroi lëndët fizika I e fizika II dhe bazat e fizikës atomike në disa degë të Fakultetit Teknik të UP-së. Në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore të Universitetit të Prishtinës, në seksionin e fizikës, ligjëroi lëndën mekanika kuantike. Deri më 1992 është avancuar në të gjithë titujt universitarë. Ka marrë pjesë në disa konferenca ndërkombëtare. Jeton në Suedi. (Zahadin Shemsedini)

LLONÇARI Njazi (1954-). Pikturor. Lindi në Pejë. Kreu shkollimin fillor dhe gjimnazin në Pejë, studimet për pikturë në Akademinë e Arteve në Prishtinë (1978). Punoi për shumë vjet në arsim si pedagog i artit figurativ. Në vitin 1999 migroi në SHBA, në Nju-Jork, ku jeton dhe merret me pikturë. Ishte anëtar i Shoqatës së Artistëve Figurativë të Kosovës (SHAFK) që nga vitit 1979 dhe mori pjesë në disa ekspozita dhe aktivitete të saj. Në kuadër të SHAFK-ut mori pjesë në të gjitha ekspozitat kolektive në vitet 1980-1999: në Sallonin Pranveror, Bienalen e Vizatimit, ekspozitat vjeshtore etj. Hapi disa ekspozita personale në Pejë, Prishtinë dhe SHBA dhe ishte fitues i çmimit blerës në Sallonin Pranveror më 1981 dhe në Ekspozitën e Shoqatës së Artistëve Figurativë të Pejës më 1982. (Ilir Muharremi)

LLUÇANI. Fshat në komunën e Bujanocit, 5 kilometra në jugperëndim të qytetit. Shtrihet në brigjet e Moravës së Binçës, në dalje të saj nga gryka e Konçulit në fushën e Bujanocit, në lartësi mbidetare 410-420 m. Shtëpitë janë të ndërtuara në të dy anët e lumit, si dhe të rrugës regjionale Gjilan-Bujanoc. Lluçani është vendbanim i vjetër, për të cilin dëshmojnë gjetjet e shumta të kulturës materiale. Mbi fshat, në brigjet e Moravës së Binçës, ekzistojnë edhe sot e kësaj dite shtyllat e urës së vjetër, që datojnë nga periudha romake, nëpër të cilën kalonte rruga që shpinte në fushën e Preshevës. Lluçani në vitin 1961 kishte 997 banorë, ndërsa në vitin 2002 kishte 1,538 banorë rezidentë. Një numër i konsiderueshëm i banorëve punojnë në botën e jashtme. Tokat bujqësore, të cilat shtrihen në rrafshin aluvial të Moravës së Binçës dallohen për nga pjellshmëria e lartë dhe afërsia e ujërave nëntokësore. Edhe pse në kushte të volitshme, bujqësia është e tipit ekstensiv. (Arsim Ejupi)

LLUGAXHIU Qazim (1907-1986). Antikomunist, veprimtar i lëvizjes kombëtare. Emri i

tij i plotë ishte Qazim Sefedin Reçica-Llugaxhia. Lindi në Llugaxhi të Lipjanit. Ndërmjet dy luftërave botërore kundërshtoi pushtetin e Jugosllavisë monarkiste. Me rënien e Jugosllavisë më 1941 u rreshtua në anën e pushtetit të ri, që u vendos në Kosovë. U zgjodh kryetar i komunës së Babushit (1941-1942), më pas kryetar i Komitetit Qarkor të Lidhjes së Dytë të Prizrenit për Lipjan (1943-1944). Pas vendosjes së pushtetit komunist në Kosovë, në fund të vitit 1944 iu bashkua forcave nacionaliste. Ishte ndër udhëheqësit e forcave nacionaliste shqiptare që vepronin në Zonën IV të Mbrojtjes Kombëtare të Kosovës. Në mbledhjen e 1 dhjetorit të 1944, që u mbajt në Tërpezë të Moravës së Epërme, ku u formua Shtabi Suprem i Kosovës, u emërua zëvendëskomandant. Mori pjesë në luftën për çlirimin e Ferizajt (2 dhjetor 1944). Ishte pjesëmarrës në kuverndin e Kopilaçës (15-16 gusht 1945) në Karadakun e Shkupit. Në pamundësi për të qëndruar në vend, iku në Greqi. Nga aty kaloi në Turqi, duke mos e ndërprerë veprimtarinë për çështjen kombëtare. Më 1986 u vra në Turqi nga shërbimi sekret jugosllav. (Skënder Lutfiue).

LLUGIQI Besa (1986-). Soprano. Lindi në Prishtinë, ku kreu Shkollën e Mesme të Muzikës. U diplomua në Fakultetin e Arteve, drejtimi i solokëndimit. Kreu studimet master në



BESA LLUGIQI

Fakultetin e Muzikës në Shkup. Është anëtare e Korit të Filarmonisë - Operës së Kosovës, ku u prezentua edhe si soliste me orkestrën e saj. Mësimdhënëse e angazhuar e solokëndimit në Fakultetin e Arteve në Prishtinë dhe në Pejë. U prezentua në festivale dhe koncerte në Kosovë, Maqedoni, Shqipëri, Austri, Francë, Itali, Kroaci. Ka vijuar masterklasat me artistë të njohur si: J. Gjipali, H. Schmit, P. Ziethen, M. Schmiede, M. Leka. Më 2011 debutoi në Teatrin e Operës dhe Baletit (TOB) në Tiranë me operën "Turandot" (Puccini). Më 2010 u ftua nga dirigjenti austriak C. Buchler në meshën e kompozitorit C. Franck në Austri dhe Itali. Në teatrin Ruso në Bullgari u prezentua me rolin e Mimit në "La Boheme" të Puccinit. Në TOB në Tiranë interpretoi Lauretën te "Gianni Schicchi" Requiemin e Faure-së. Në vitet 2003-2005

mori katër herë çmimin e parë në garat ndërkombëtare në Prishtinë, organizuar nga fondacioni “Ars Kosova”. E shpërblyer me “interpretimin më të mirë të kompozitorëve shqiptarë”, çmimin e parë në garat “Jorgjia Truja”, Shqipëri (2009) dhe në “Marie Kraja”, Tiranë, ku mes 94 këngëtarëve ndërkombëtarë hyri në 10 finalistet dhe me çmimin “Grand Prix” në konkursin “Elena Nikolai” në Bullgari. E ftuar edhe të “Rekviemi” i Mozartit në njërin nga festivalet e njohura në Sofje. (Arnisa Rexhepi)

LLUGIQI Vjollca (1987-). Balerinë. Lindi në Prishtinë. Kreu shkollën e mesme të muzikës “Prenk Jakova”, drejtimin e baletit, si dhe Fakultetin Ekonomik në Prishtinë. Si soliste u inkuadrua në vitin 2002 në trupën e baletit të Kosovës dhe ishte pjesëmarrëse në të gjitha aktivitetet që u zhvilluan gjatë kësaj periudhe, por edhe në festivale të ndryshme jashtë vendit, si në Shqipëri, Maqedoni, Turqi, Itali dhe Zvicër. Mori pjesë në shfaqjet: “Performancë”, “Kontrast”, “Transicioni”, “S’po dëgjohet gongu” me koreografi të Gjergj Prevazit; “Balloja e diplomës”, “Dashuria që vret”, “Copelia”, “La Syphide” me koreografi të I. Kemit, pastaj në shfaqjet “Aty ku drita bie”, “Don Kishoti”, “Dasma”, “Fluturimi drejt dritës”, “Karmen”, “Bukuroshja e fjetur” etj. Është fituese e disa çmimeve dhe mirënjohjeve për kreacion artistik. (Selman Jusufi)

LLUKA Tahir (1830?-1908). Poet, hoxhë, mësues, përkthyes. Lindi në fshatin Llukë e Epërme midis viteve 1830-1845. Pas mbarimit të studimeve në Stamboll u emërua mësues në Prishtinë në shkollën e lartë “Fatih” të Stambollit. Ishte njohës i mirë i gjuhëve dhe i letërsisë orientale. Mbante kontakte me rilindësit e shquar shqiptarë që vepronin në Stamboll. Pas vitit 1881 u kthye në vendlindje, ndërsa në vitin 1889, në Llukën e Epërme, nahija e Gjakovës, hapi mejtepin, ku mësimi zhvillohej edhe në gjuhën shqipe. Për mbajtjen e shkollës kishte hapur një dyqan në një dhomë të mejtepit. Për nevojat e mejtepit hartoi disa tekste në gjuhën shqipe me grafi arabe, por duke bërë disa kombinime të grafemave dhe duke iu shtuar shenja diakritike. Ky alfabet i njohur si alfabeti i “Tahir ef. Llukës”, i hartuar më 1878, u përdor në mejtepin e tij dhe më gjerë. Është autori i tri veprave në gjuhën shqipe me grafi arabe: “Shkenca e besimit islam”, “Broshurë

mbi moralin” dhe “Urata e besimtarit”. Shkoi në Stamboll dhe nuk u kthye më në vendlindje. Rrethanat e vdekjes mbeten të paqarta. (Sadik Mehmeti)

LLUKARI Jak (i Pjetrit) (Giacomo Luccari di Pietro) (1551-1615). Historian dhe shkrimtar raguzan me origjinë arbërore. Në veprën e tij historike-letrare “Analet e Raguzës”, botuar së



JAK LLUKARI

pari në Venedik (1605) dhe më pastaj në Raguzë (1790), u ka kushtuar vend qendror ngjarjeve dhe personazheve të Raguzës, që lidhen me historinë mesjetare të Arbërisë, pra edhe të Kosovës. Në katalogun e autorëve të shfrytëzuar prej tij ndeshim edhe Marin Barlecin, Gjergj Bardhin, Engjëll Drishtjanin, si dhe Kronikën e Tivarit. Llukari ofron të dhëna interesante për Gjergj Kastriotin-Skënderbeun. Nga një pasazh i librit të tij dëshmohet origjina hasiane e heroit: “Gjon Kastrioti zotërues i Krujës, të cilit familja i rrjedh nga fshati Kastrat nën jurisdkisionin e Hasit të Arbërisë, jo fort larg nga lumi Dri”. Llukari nuk ndalet shumë për t’i trajtuar betejat e Kosovës, edhe pse treva e Kosovës së sotme përmendet shpesh në veprën e tij. Për Betejën e Parë të Kosovës (1389) jep vetëm të dhëna fragmentare: “Vitin e njëjtë (1389), Murati i Turqisë depërton në Campo di Merula, që gjermanët e thërrasin Amselveld, hungarezët Rigomezi, e turqit Cossovo”, dhe buzë brigjeve të Sitnicës e shpartallon dhe ia pret kokën Llazarit, kontit të Serbisë, të cilin e kishte tradhtuar Vuk Brankoviç, dhëndër i tij. Në vendin e njëjtë e vrau Muratin Milosh Kobiliç (Milosc Cobilich)”. Llukari nuk ndalet shumë për ta trajtuar edhe Betejën e Dytë të Kosovës (1448), por e vë në spikamë ndihmën e Skënderbeut, që i kishte ofruar Janosh Huniadit. (Jahja Drançolli)

LLUKARI. Fshat në verilindje të Prishtinës, 4 km nga qendra. Përmendet si vendbanim në disa dokumente të shkruara. Sipas defterit osman (1477) ishte mëhallë e Prishtinës, me 28 shtëpi. Në defterët osmanë është i regjistruar me emrat Makoci i Epërm dhe Makoci i Poshtëm. Haset edhe në një hartë austriake të vitit 1689. Pas luftërave austro-turke të viteve 1687-89,

një pjesë e popullsisë shpërngulet në fshatrat malore të Gollakut (Radash dhe Gjytet). Në vitin 1913 kishte 166 banorë, në vitin 1948 kishte 36 shtëpi me 316 banorë, ndërsa në vitin 1996 kishte 140 shtëpi me 1,381 banorë. Nëpër fshatin Llukur kalon rruga automobilistike rajonale Prishtinë-Medvegjë-Leskoc dhe Prishtinë-Mramor-Gjilan. Nga objektet e standardit shoqëror, fshati ka shkollën fillore, shtëpinë e kulturës dhe bibliotekën, stacionin shëndetësor, disa objekte tregtare dhe shërbyese etj. (Nazif Gashi)

LLUMNICA Ejup (1979-). Gazetar i sportit. Lindi në Prishtinë. Në vitin 1999-2002 punoi si gazetar i sportit në të përditshmen "Rilindja". Gazetarinë sportive e vazhdoi në gazetën "Kosova sport" deri më 2005, pastaj në gazetën "Iliria post". Gjatë viteve 2007-2014 punoi në të përditshmen "Zëri" dhe "Topi", ndërsa më vonë në të përditshmen "Kosova sot". (Besim Kajtazi)

LLUNJI Ali (1939-). Gazetar. Lindi në Ulqin. Shkollimin fillor e kreu në vendlindje, shkollën normale dhe studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe i mbaroi në Prishtinë. Punoi mësimdhënës, më pas në Radio Prishtinë dhe në redaksinë e programit shqip të Televizionit të Beogradit, ndërsa nga viti 1974 si gazetar dhe

redaktor i programit dokumentar-fejtonistik i Televizionit të Prishtinës (TVP). Gjatë punës në TVP realizoi serialet dokumentare për arbëreshët e Italisë, për arbëreshët e Zarës, shqiptarët e Sirisë etj., si dhe një sërë portretesh krijuesish të fushave të ndryshme. Punoi në "Librin shkollor" dhe pas luftës në Radio-Televizionin e Kosovës. Ka botuar një sërë tekstesh publicistike në gazeta dhe revista dhe është përkthyes i teksteve shkollore dhe beletristike. Është dhe bashkautor i disa monografive për Xhemë Gostivarin, Shpëtim Robajn, Beqir Kastratin etj., si dhe i veprave autoriale: "Në kalimerë" (1967), "Harapët e Ulqinit" (2013), "Lugu i Xhemiles" etj. (Ibrahim Berisha)

LLUZHANI. Fshat në jug të Podujevës, rreth 11 km nga qendra komunale. Është vendbanim fushor i tipit gjysmë të dendur. Sipërfaqja e territorit të fshatit është 230 ha. Si vendbanim përmendet në disa dokumente të shkruara mesjetare. Në defterin kadastral të vilajetit Vëllk (1455) përmendet si vendbanim me 41 shtëpi. Sot ka rreth 60 shtëpi me 800 banorë. Popullsia merret kryesisht me bujqësi. Nga objektet e standardit shoqëror ka shkollën fillore, qendrën e mjekësisë familjare etj. (Skender Halimi)

M

MACINGER Joahim (Joachim Matzinger) (1968-). Gjuhëtar, përkthyes, albanolog austriak. Lindi në Vjenë. Kreu studimet pasuniversitare për gjuhësi krahasimtare e indoeuropiane



JOAHIM MACINGER

në Vjenë, ndërsa dokto-roi në Jenë të Gjermanisë (2001). Gjatë periudhës 1992-1995 punoi si asistent në Universitetin e Vjenës, ndërsa në periudhën 1997-2006 punoi si hulumtues në departamentin e studimeve indoeuropiane në Universitetin e Jenës. Në vitet vijuese (2006-2010) punoi si hulumtues edhe në Universitetin e Vjenës, në projektin për foljet e shqipes së vjetër në kontekstin ballkanik, bashkë me Shtefan Shumaherin. Punoi edhe në një projekt për Buzukun. Botoi një varg punimesh për shqipen dhe gjuhët e Ballkanit, ndër të cilat monografitë: “Teksti i vjetër shqip ‘E mbsuame e krështerë’ e Lekë Matrëngës nga 1592, një hyrje në gjuhësinë shqiptare” (2006); “Foljet e shqipes së vjetër. Leksik, parahistori dhe etimologji” (Die Verben des Altalbanischen. Belegurterbuch, Vorgeschichte und Etymologie, bashkautor me Shumaher, 2013), ndërsa pritet të dalë së shpejti edhe vëllimi për Buzukun. Ka publikuar punime që lidhen me gjuhësinë krahasimtare, ku në shumicën e rasteve shqipja është në rend të parë. (Lindita Rugova)

MAGURA. Fshat në perëndim të Lipjanit, 13 km nga qendra komunale. Shtrihet rrëzë Goleshit, në të dy anët e vijës hekurudhore, në lartësi mbidetare 557 m. Është vendbanim xehetar i tipit të dendur, me sipërfaqe të zonës kadastrale prej 326 ha. Magura përmendet po me këtë emër në vitin 1455. Në vitin 1914

kishte 165 banorë, ndërsa tani ka rreth 3,000 banorë. Xeherorja e magnezitit funksionon që nga viti 1927, në të cilën shumica e banorëve të këtij vendbanimi dhe të rrethinës siguronin ekzistencën. Ka shkollë 9-vjeçare dhe disa objekte të tjera të infrastrukturës me karakter lokal. (Ibrahim Ramadani)

MAGJUPËT. Kategori sociale mesjetare e bukëpjekësve të manastireve, emri i të cilëve konsiderohet edhe burim i emrit të etnisë. Dëshmia më e vjetër e emrit dhe e kategorisë sociale (*magjupci*) gjendet te krisobulat e Deçanit të viteve 1330-1335, ku përmenden 8 pjesëtarë nga Plava të kësaj kategorie sociale, pa dhënë asnjë sqarim as për përkatësinë etnike e as për profesionin që ushtronin. Në bazë të etimologjisë së fjalës, besohet se kemi të bëjmë me skllëvër që piqnin bukë për personelin e manastireve. Këtë e thotë edhe vetë fjala, e cila në serbishten mesjetare ka hyrë nga greqishtja e mesme. Në shqipen fjala *magjup* është huazuar nga serbishtja kishtare. Ndërkaq, në krisobulën e Banjskës të viteve 1313-1318 ndeshet edhe nocioni “*magjup'nica*”, që ka kuptimin e vendit ku mbahen rezervat e drithit. Ende mbetet për t'u sqaruar nëse emërtimi ka të bëjë me emrin etnik, apo vetëm me profesionin. Rrethana që 8 magjupët përmenden për banorë të Plavës, duke mos thënë shprehimisht se ishin pjesëtarë të një etnie të ndryshme nga ajo vendëse, tregon se emërtimi në këtë rast nuk ishte në funksion të emrit etnik. Prandaj emërtimet *mag-jup* e *magjup'nica* janë më të hershme se koha e ardhjes së magjupëve në Kosovë nga India e largët, sepse magjupët dëshmohen nga literatura së pari në vitin 1322, në Kretë, dhe pastaj më 1346 në Peloponez, ndërsa në Europë dhe mbase në Kosovë u përhapën më vonë, në shek. XV. Së këndejmi, është e besueshme se emri i

profesionit (*mag-jup*) me prejardhje bizantine, me kuptimin e hershëm “bukëpjekës sklevër të manastireve“ u përdor më vonë nga shqipfolësit, për të emërtuar popullatën ardhëse të përbuzur deri në shkallë skllavërie. (Skënder Gashi)

MAHAIRA. Armë antike, thikë e madhe ose shpatë me një teh. Ndonëse janë përshkruar shpesh në vepra arti, gjetjet arkeologjike të këtij tipi të shpatës janë të rralla dhe studiuesja M. Paroviq-Peshikan disa i sheh si mahaira dardane. Në artin grek është e dredhur te pjesa e prerjes së tehut drejt majës, andaj pesha e koncentruar në këtë pjesë të tehut e bën prerjen më të fuqishme. Në tekste periodike mahaira ka shumë kuptime dhe mund t'i referohet çfarëdo thike ose shpate, madje edhe një bisturie të kirurgut. Në kontekste marciale i referohet tipit të shpatës me një teh, e dizajnuar kryesisht më shumë për të prerë sesa për të therë. Homeri e përshkruan si thikë jo aq e madhe shtëpiake. (Sedat Barajliu)

MAHMUDBEGOLLI Hydaverdi Pashë (-1695). Pushtetar i lartë dhe komandant ushtarak osman. Njëri nga pinjollët e rëndësishëm të familjes Mahmudbegolli të Pejës. Doli në skenë në kohën e depërtimit të ushtrisë austriake në hapësirat shqiptare. Në vitin 1688 u emërua sanxhakbej i Dukagjinit dhe i Prizrenit, njëherësh përgjegjës për sigurinë e sanxhakut të Nishit. Me forcat e tij lokale, bashkë me Mahmud Pashë Gjakovën, sanxhakbej i Hercegovinës, Mustafa Pashë Zurnapën, sanxhakbej i Shkupit dhe përgjegjës për sigurinë e Jeni Pazarit, u mundën nga forcat austriake në betejën e Nishit në shtator të vitit 1689. Një vit më vonë Mahmud Pasha, bashkë me pashallarët e tjerë shqiptarë (Koxha Halil Pashë Shkupi, Mustafa Pashë Zurnapa, Mahmud Pashë Gjakova, Xhafer Pashë Vlora), të ndihmuar edhe nga ushtria tatarë e Krimesë, arritën që më 1 dhe 2 janar 1690 ta rikthenin Kaçanikun dhe tërë Kosovën e sotme nën administrimin osman, duke ngadhënjyer mbi forcat e Habsburgëve, të ndihmuar edhe nga vullnetarët vendorë. Në vitin 1692, Mahmud Pasha ishte pushtetari më i fuqishëm i Ballkanit, sepse mbante pozitën e bejlerbeut të Rumelisë dhe atë të sanxhakbeut të Janinës. Por, u vra më 22 shtator të vitit 1695 në luftë kundër forcave austriake të gjeneralit Veteran. I biri i tij, Hysejn Pasha, ishte për disa vjet sanxhakbej i Dukagjinit, deri kur vdiq më

1714. Nipi i tij, Tahir Pasha, e vazhdoi detyrën e sanxhakbeut, ndërkaq në vitin 1739 e shohim si sanxhakbej të Delvinës. Edhe i biri i Tahir Pashës, Mahmud Pasha II qe sanxhakbej i Dukagjinit deri në vitin 1730, ndërkaq nga ky vit ishte edhe sanxhakbej i Shkodrës, deri kur u vra nga Çauhsollët në vitin 1739. (Nehat Krasniqi)

MAHMUTI Bardhyl (1960-). Aktivist i lëvizjes çlirimtare, anëtar i Drejtorisë Politike të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Lindi në Tetovë. Kreu shkollimin fillor dhe të mesëm



BARDHYL
MAHMUTI

në Tetovë dhe në Prishtinë. Si pjesëmarrës në demonstratat e vitit 1981 u dënua me 7 vjet burg. Pas daljes nga burgu e vazhdoi aktivitetin politik në kuadër të Lëvizjes Popullore për Republikën e Kosovës dhe në konferencën e parë u

zgjodh anëtar i Komitetit Drejtues. Në vitin 1990 emigroi në Zvicër. Studioi për shkencat politike në Universitetin e Lozanës dhe kreu studimet pasuniversitare po në këtë universitet (1997). Gjatë luftës në Kosovë ishte anëtar i Drejtorisë Politike të UÇK-së dhe shef i grupit të saj diplomatik. Pas luftës, në Kuvendin e parë të Partisë për Bashkim Demokratik u zgjodh kryetar i saj. Ishte ministër i Punëve të Jashtme në Qeverinë e Përkohshme të Kosovës dhe njëri nga themeluesit e Partisë Demokratike të Kosovës. Në vitin 2007 kaloi me vendbanim të përhershëm në Tetovë dhe atje themeloi partinë politike Bashkimi Demokratik Shqiptar. Ka shkruar dhe botuar një sërë tekstesh publicistike për probleme të ndryshme politike. (Ismail Sylja)

MAJANCI Afrim (1962-). Boksier, trajner. Filloi të merret me boks në KB “Prishtina”. Në vitin 1981 inkuadrohet në ekipin e parë, ku e kishte trajner Lah Nimanin. Ka qenë boksier i kategorive të lehta. Me KB “Prishtina” fitoi një titull të kampionit të ish-Jugosllavisë (1985) në konkurrencën ekipore. Fitoi titullin e kampionit ballkanik në vitin 1986. Në vitin 1987 fitoi medalje bronzi në Lojërat e Mesdheut (Lataki, Siri). Ka të zhvilluara rreth 210 meçe, ndërsa ka qenë edhe anëtar standard i përfaqësueses së ish-Jugosllavisë në boks. Është trajner në KB “Prishtina”. (Bekim Aliu)

MAJER Antun (Mayer) (1883-1957). Gjuhëtar, indoeuropianist, historian, ilirolog dhe paleograf kroat. Lindi në Knin. Ishte profesor në Universitetin e Zagrebit. Studiues i gjuhëve indoeuropiane që fliteshin në Ballkan, veçanërisht i ilirishtes. Veprat e tij të njohura janë: “Gjuha e ilirëve të vjetër” (Die Sprache der Alten Illyrier I, 1957 dhe II, Vjenë 1959), pastaj “Pozita e gjuhës ilire në mesin e gjuhëve indoeuropiane” (Položaj ilirskog jezika među indoevropskim jezicima, 1936), “Ilirët” (Illyrisches, 1939); “Vidasus, Silvani ilir” (Vidasus, der illyrische Silvanus, 1942) etj. Vepra e tij dyvëllimëshe për gjuhën ilire është gjithnjë vepra bazë për studimet iliristike. Në të janë shënuar dhe interpretuar nga aspekti etimologjik elementet leksikore dhe onomastike që mendohet të jenë ilire. Në vëllimin e dytë ka përpjekje për ta interpretuar materialin gjuhësor në aspektet e tij gramatikor dhe të strukturës gjuhësore. (Sejdi Gashi)

MAJER Gustav (Meyer) (1850-1900). Gjuhëtar, albanolog, indoeuropianist, profesor. Lindi në Gros Strehlitz të Gjermanisë. Konsiderohet ndër albanologët më të njohur. Studioi filologjinë klasike, gjuhët indo-europiane, greqishten e re dhe sanskritishten. Ishte profesor i gjuhëve të vjetra në Universitetin e Gëtingenit, të Pragës dhe të Gracit. Më 1881, si profesor i Universitetit të Gracit, i intensifikoi studimet e albanologjisë. Botoi veprat: “Studime shqiptare I” (1882), “Për indoevropianishten - e kryera në morfologjinë e shqipes” (Firence, 1886), “Gramatikë e përmbledhur e shqipes” (Lajpcig, 1888), “Elementet latine në gjuhën shqipe” (1888), “Fjalor etimologjik i gjuhës shqipe” (Strasburg, 1891). Mbrojti tezën e pre-jardhjes së shqipes nga ilirishtja dhe përcaktoi pozitën e saj në kuadër të gjuhëve indoeuropiane. E mbivlerësoi elementin e huazuar në shqipe, sidomos elementin roman, duke e cilësuar atë si një gjuhë “gjysmëromane”. Bëri fjalorin e parë etimologjik të shqipes. (Hana Radoniqi)



GUSTAV MAJER

MAJER-LYBKE Vilhelm (Wilhelm Meyer-Lübke) (1861-1936). Gjuhëtar, romanist, filolog zvicerian i shkollës “Gramatikanët e rinj”. Bëri studime të ndryshme krahasuese të gjuhëve romane. Studioi filologjinë indoeuropiane në Cyrih dhe Berlin, doktoroi për latinishten më 1883. Ishte romanisti më i rëndësishëm i kohës së tij. Mbajti mësimë në Jenë, Cyrih, Vjenë dhe Bon. Veprat e tij janë: “Gramatikë e gjuhëve romane” në katër vëllime, “Hyrje në studimin e gjuhësisë romane”, “Fjalori etimologjik i romanishtes”. U mor dhe me studimin e huazimeve latine të shqipes, ashtu si dhe me elementet e përbashkëta të shqipes me rumanishten. (Pranvera Osmani)

MAKEDONI (Machedonius a Dardania de Ulpianis). Ipeshkëv nga Ulpiana e Dardanisë. Mori pjesë në koncilin kishtar të Serdikës të vitit 342, i renditur me numrin rendor 35 në mesin e 170 ipeshkvijve të tjerë. Me të ishin dhe katër ipeshkvij të tjerë që vinin nga Dardania. Edhe në koncilin e pestë kishtar të Konstandinopojës të vitit 553, ku ishte pjesëmarrës ipeshkvi Pali nga Justiniana Secunda, që nënshkruhej si Episcopus Ulpianensis, ndonëse qyteti i Ulpianës tashmë ishte riemërtuar në Justiniana Secunda. Prania e Makedonit dhe e ipeshkvijve të tjerë nga Dardania në koncile të ndryshme kishtarë të përmasave të tilla dëshmon nivelin e lartë të organizimit kishtar dardan. (Arben Arifi)

MAKEDONISHTJA. Gjuha e makedonëve të lashtë, që shtrirjen më të madhe e ka pasur në kohën e Mbretit Filip II dhe të të birit të tij, Aleksandrit të Madh (336-323 p.e.s.). Shtrihej midis greqishtes, ilirishtes dhe trakishtes e frigishtes. Nuk është e shkruar, ndërsa gjuhë e shkrimit e Makedonisë ishte greqishtja. Nga emrat dhe ndonjë glosë janë hetuar ndryshime midis makedonishtes dhe greqishtes. Disa autorë e lidhin me varietete të greqishtes veriperëndimore. Është folur gjatë mileniumit të parë p.e.s. I përket familjes së gjuhëve indoeuropiane. (Adelinë Selmani)


MAKIQI Aziz (1958-). Hendbollist, trajner. Lindi në Mitrovicë, hapat e parë të hendbollit i nisi te skuadra e “Trepçës” në vitin 1974. Krahas “Trepçës” bëri karrierë edhe te “Borci” i Ferizajit dhe luajti me sukses në Ligën e parë dhe të dytë të ish-Jugosllavisë. Makiqi gjatë asaj kohe ishte ikonë e skuadrave kosovare dhe vlerësohet ndër hendbollistët më të mirë në historinë e hendbollit të Kosovës. Përveç karrierës në Kosovë, Makiqi luajti edhe në Bundesligë të Gjermanisë, te skuadrat “US Hofeeier” e “TVS

Eermerkirchen”. Gjithashtu ka bërë karrierë edhe te skuadra e “Proleterit” të Zrenjaninit (Vojvodinë), pastaj në Austri dhe Itali. Karrierën si hendbollist e mbylli te skuadra e njohur kroate “Umag”, ku ishte edhe trajner për një periudhë. Së fundi ka marrë mirënjohje edhe nga Federata e Hendbollit të Kosovës për kontributin e dhënë në këtë sport gjatë periudhave më të vështira. (Arsim Maxhera)

MAKOLLI Zeqir Bislim (Shyt Mareci) (1909-1947) Veprimtar i rezistencës antikomuniste. Lindi në Marec të Prishtinës. Në vitet 1942-1943 u përfshi në forcat vullnetare që luftonin kundër forcave çetnike dhe komuniste, që vepronin edhe në territorin e Kosovës. Nga viti 1944 ishte njëri nga udhëheqësit e rezistencës antikomuniste. Iu bashkua radhëve të luftëtarëve për mbrojtjen e kufirit të Kosovës nga depërtimi i forcave partizane serbe-bullgare në frontin Podujevë-Prapashticë-Tugjec-Bujanoc. Nga fundi i vitit 1944, çeta e tij operonte në tërë territorin e Gallapit. Më 23 dhjetor 1944, me një grup bashkëluftëtarësh, luftoi bashkë me Idriz Hajrullahun për çlirimin e Gjilanit nga njësitet partizane, të cilat kryenin masakra mbi popullsinë civile shqiptare. Ishte pjesëmarrës i Kongresit të Lipovicës, mbarëvajtjen e të cilit e siguroi edhe çeta e tij. Bashkëpunoi me udhëheqës të tjerë të rezistencës, veçmas me çetën e Shemsi Mramorit. U vra nga forcat e OZN-ës në Meshinë të Kamenicës (1947). (Zijadin Gashi)

MAKSUT Shakir (1944-2012). Gazetar. Lindi në Prishtinë, ku kreu shkollimin fillor, të mesëm dhe studimet për gjuhë dhe letërsi turke në Fakultetin Filozofik. Ishte ndër gazetarët e parë dhe themelues i medias turke në Kosovë. Në vitin 1963 punoi në Radio Prishtinë, më pas në vitin 1973 ishte themelues i programit në gjuhën turke në Televizionin e Prishtinës. Kur u themelua gazeta “Tan” ushtroi detyrën e drejtorit në këtë institucion. Në kohën e ish-Jugosllavisë mbajti edhe funksione politike dhe u angazhua për të drejtat e pakicës turke në Kosovë. (Agnesa Rashiti-Gllobodëri)

MAKSUTAJ Mervete (1978-1998). Luftëtare e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), dëshmore. Lindi në fshatin Arbanë (ish-Orobërdë) të Istogut. Në qershor të vitit 1998 iu bashkua radhëve të UÇK-së në Glllogjan të Deçanit. Që



MERVETE
MAKSUTAJ

andëj, në fillim të muajit korrik, u transferua në Shtabin e UÇK-së në Shqiponjë (ish-Jabllanicë) të Dushkajës, në njësitin ushtarak “Vazjat me kordele të kuqe”. Mori pjesë në luftimet e zhvilluara në betejën e Shqiponjës (2 gusht 1998), pastaj në Lumbardh etj. Kreu një varg aksionesh në prapavijë të armikut, siç ishte aksioni kundër postës së policisë serbe në Çallapek (Pejë) më 15 shtator. Në vjeshtën e vitit 1998 u transferua në rajonin e përgjegjësisë së Brigadës 133 “Adrian Krasniqi”. Në dhjetor të vitit 1998, së bashku me bashkëluftëtarin e saj Besnik Shalën, ndërmori aksionin në Spitalin Rajonal të Pejës, për shpëtimin e një bashkëluftëtari të plagosur, i cili po keqtrajtohej nga policia serbe. Pas përlëshjes me forcat serbe brenda e jashtë objektit të spitalit, në kushte të një rrethimi të hekurt, M. Maksutaj qëllohet nga snajperistët e njësisë speciale të Serbisë në oborrin e spitalit. Presidentja e Kosovës e dekoroi me Urdhrin “Luftëtari i lirisë Adem Jashari” (2012). (Fetnete Ramosaj)

MAKSUTI Izer (1973-). Gjuhëtar, gjermanist, profesor universiteti. Lindi në Tuhin të Kërçovës. Në Kërçovë dhe Tetovë kreu shkollën e mesme, ndërsa studimet për gjuhësi, gjermanistikë dhe translatologji i kreu në Universitetin e Vjenës, ku më pas kreu studimet pasuniversitare dhe të doktoratës. Punoi në Universitetin e Europës Juglindore në Tetovë (2003-2007), ndërsa më pas në Universitetin e Tetovës. Është sekretar shkencor i Seminarit Ndërkombëtar të Albanologjisë në Tetovë. Mban mësim edhe në Universitetin e Prizrenit. U mor me ndërkom-bëtarizmat e shqipes dhe nga kjo fushë botoi librin “Ndërkombëtarizmat në gjuhën shqipe” (Internationalismen im Albanischen, Saarbrücken 2009). Më 2010 botoi monografinë për ndikimet gjuhësore të gjermanishtes në shqipen. Është bashkëbotues i librit “Shqiptarët në Republikën e Maqedonisë” (Die Albaner in der Republik Makedonien, Vjenë 2006) etj. (Berton Sulejmani)

MAKSUTOVIÇ Xhelku (Gelku Maksutovici) (1931-). Historian rumun me origjinë shqiptare. Lindi në Plojesht nga babai shqiptar dhe nëna

rumune. Shkollimin fillor dhe të mesëm i kreu në vendlindje, ndërsa Fakultetin e Historisë në Universitetin e Bukureshtit (1956). Në vitin 1980 mbrojti në Bukuresht tezën e doktoratës mbi rezistencën shqiptare gjatë Luftës së Dytë Botërore. Ka afirmuar komunitetin shqiptar dhe ka përforcuar miqësinë ndërmjet Rumanisë dhe Shqipërisë, duke botuar në Rumani, Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoni studime dhe artikuj mbi lidhjet rumune-shqiptare. Në maj të vitit 1990 themeloi shoqatën Bashkësia Kulture e Shqiptarëve të Rumanisë. Në gusht të vitit 1993 themeloi dhe botoi serinë e re të revistës “Albanezul-Shqiptari”. Në vitin 1995 organizoi simpoziumin për 400-vjetorin e ardhjes së 15 mijë shqiptarëve në veri të Danubit (1595). Në vitin 1999 dha kontribut për organizimin e një manifestimi në shenjë solidariteti me Kosovën. Në Rumani botoi këto vepra: “Historia e komunitetit shqiptar të Rumanisë” (1992), “Mbi shqiptarët dhe Shqipërinë” (1995), “Nën shenjë e shqiponjës” (2001), “Historia e shqiptarëve të Rumanisë” (2003). etj (Zeqirja Idrizi)

MALA Agim (1951-2007). Poet. Lindi në Gjakovë, ku kreu shkollën fillore dhe gjimnazin. U diplomua në Fakultetin e Mjekësisë në Universitetin e Prishtinës, ku studio dhe gjuhën angleze. Me krijimtari letrare u paraqit në fillim të viteve ’70. Ka punuar si gazetar e redaktor në gazetën e studentëve “Bota e re” (1976-1978), në të përjavshmen “Zëri i rinisë” (1978-1981) dhe në gazetën “Komunisti” (1981-1987). Një kohë ishte drejtor i Radiotelevizionit të Prishtinës (1987-1990). Nga viti 1990 jetoi në mërgim, në fillim në SHBA, në Kroaci, pastaj në Zvicër. Në vitin 1993 ka nisur të organizojë botimin e shtypit shqiptar në Europë, duke qenë bashkëbotues dhe botues i gazetave “Eurozëri”, “Bota sot”, “Java shqiptare” dhe “Zëri ditor”. Ka botuar librat me poezi: “Fjalë e vetmi” (1978), “Dritarja që s’hapet” (1981), “Pamjet pa ne” (1984), “Gjak në ëndërr” (1990); pastaj librin me tregime “Kortezhi i lagur” (1987) dhe dramën “Ventrusët” (1986) dhe “Teatri obskur” (1990). Poezitë e tij janë përkthyer në disa gjuhë të huaja, kurse në gjuhën serbokroate i është botuar libri “Shtëpia në savanë” (1985). Vdiq dhe u varros në Lucern të Zvicrës. (Shaip Beqiri)

MALA Muhamet (1961-). Historian medievalist, profesor universiteti. Lindi në Pejë, ku



MUHAMET MALA

kreu shkollimin fillor dhe të mesëm. Studimet për histori i kreu në Fakultetin e Filozofisë të Universitetit të Prishtinës (UP) (1987), ku kreu edhe studimet pasuniversitare dhe mbrojti tezën e magjistraturës rreth marrëdhënieve të Kotorrit me trevat shqiptare gjatë shek. XIV-XV (1996). Në Universitetin e Prishtinës, në bashkëpunim me Universitetin e Zagrebit, përgatiti dhe mbrojti tezën e doktoratës për shqiptarët dhe Europën Qendrore gjatë shek. XII-XVII (2006). Nga viti 1993 punon në departamentin e historisë të Fakultetit Filozofik në Prishtinë, duke ushtruar edhe funksione të ndryshme në katedrën e historisë, në Fakultetin Filozofik dhe në rektoratin e UP-së. Është i angazhuar edhe si mësimmëdhënës vizitor në Fakultetin e Historisë e të Filologjisë të Universitetit Shtetëror të Tiranës. Është autor i monografisë shkencore “Shqiptarët dhe Europa Qendrore gjatë shek. XII-XVII” (2010), i tekstit “Gjeografia historike e Ballkanit, Antikiteti dhe Mesjeta I” (maket, 2007). Është gjithashtu autor i disa studimeve shkencore nga historia mesjetare dhe historia e religjioneve dhe pjesëmarrës në simpoziume shkencore brenda dhe jashtë vendit. (Jahja Drançolli)

MALA Rexhep (1951-1984). Aktivist i lëvizjes ilegale, i burgosur politik. Lindi në fshatin Hogosht të Kamenicës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa të mesmen në Gjilan. Si



REXHEP MALA

nxënës ishte ndër organizatorët dhe në radhët e para të demonstratave të vitit 1968 në Gjilan, për çka edhe u dënua. Një vit më vonë për shkak të veprimtarisë ilegale u përjashtua nga gjimnazi i Gjilanit, për t’u regjistruar pastaj në gjimnazin “Skënderbeu” të Preshevës. Në vitin 1970 punoi si mësues në Marec të Prishtinës. Gjatë vitit 1970/71 u regjistrua në fakultetin ekonomik në Prishtinë. Pasi kreu vitin e parë të studimeve, u arratis në Shqipëri, prej nga u kthye sërish dhe u dënua për kundërvajtje.

Për një kohë jetoi në disa shtete perëndimore, si në Francë, Itali, Gjermani etj. Në vitin 1974 u burgos si pjesëtarë i Grupit Revolucionar, të cilin e udhëhiqte Adem Demaçi. Pas 9 muaj hetimesh të mundimshme u dënua me 9 vjet burg. Burgun e vuajti në Prishtinë, Mitrovicë, Shtip, Prizren, Mostar etj. U lirua nga burgu më 1983. Më 12 janar 1984, në lagjën Kodra e Trimave në Prishtinë, u vra së bashku me Nuhi Berishën, në një përleshje të armatosur me forcat policore jugosllave. (Naim Musliu)

MALA-IMAMI Naile (1960-). Gjuhëtare, gazetare, përkthyes. Lindi në Medvegje, ku kreu shkollën fillore, ndërsa të mesmen e mbaroi në Prishtinë. Studioi për gjuhë dhe letërsi shqipe në Prishtinë dhe në Beograd. Në vitin 1999 u zgjodh lektore e gjuhës shqipe në Fakultetin Filologjik të Beogradit. Përktheu libra shkollorë dhe tekste letrare për revista të ndryshme në gjuhën serbe dhe kroate. Është autore e librit “Gramatika e gjuhës shqipe: fonetika dhe morfologjia”, (Beograd, 2009), dhe e dy librave të leximit për shkollë fillore për klasën e I-II (Beograd, 2010, 2011). Në vitin 2012 mbrojti në Beograd tezën e doktoratës me titull “Konvergenca dhe divergenca të sistemit rasor në arealin gjuhësor ballkanik”. Botoi artikuj shkencorë për gjuhën shqipe. Ka qenë korrespondente nga Beogradi e “Flakës së vëllazërimit”, e “Radio France Internationale” dhe e “Kohës ditore”. Është përkthyes ligjore për gjuhë shqipe në Beograd. (Lindita Rugova)

MALAJ Atë Vinçenc (1928-2000). Albanolog, folklorist, klerik. Lindi në fshatin Larje të Krajës, komuna e Tivarit, në Mal të Zi. Mësimet e para i bëri në vendlindje, shkollën e mesme



ATË VINÇENC
MALAJ

të drejtimit klasik e kreu në Shkodër, pastaj në Split dhe në Pazin. Studioi për filozofi në Dubrovnik dhe teologji në Universitetin e Zagrebit dhe më pas në Universitetin “La Sapienza” të Romës, për letërsi italiane dhe botërore. Më 1973 mbrojti temën e doktoratës “Kuvendi i Arbërit (1703)”, që është vepra e tij kryesore shkencore. Ishte famullitar i Tuzit. Ka mbajtur ligjërata nga fusha e albanologjisë në Palermo, Romë, Shkodër, Tiranë, Zagreb, Cetinje,

Prishtinë, Ulqin, Nju-Jork etj. U mor me studimin e ikonografisë së Gjergj Kastriotit-Skënderbeut dhe botoi një sërë studimesh nga fusha të ndryshme të albanologjisë. Pas vdekjes u botua në Kozencë vëllimi i tregimeve popullore arbëreshe “Tregime popullore të Shën Katarinës Shqiptare”, mbledhur dhe përkthyer italisht nga V. Malaj. Ishte themelues dhe kryetar nderi i Shoqatës Kulturore “Don Gjon Buzuku” në Ulqin dhe Tuz dhe profesor i lëndës historia e kristianizmit në Shkollën e Lartë Teologjike në Shkodër. (Krenar Doli)


MALALA Joan (Ioannes Malalas (490-pas vitit 574). Kronist bizantin me prejardhje siriane. Lindi në Antioki. U shkollua për letërsi dhe jurisprudencë. Në vitin 540, kur Antiokia u mor nga persianët, u shpërngul në Konstandinopojë, ku, si mbështetës i politikës së perandorit bizantin Justiniani I (527-565) vazhdoi të punojë në administratën shtetërore. Është autor i “Kronikës së Botës” (Hronografia) në 18 libra. Vepra e tij është kronika e parë më e madhe me karakter të krishterë në Bizant. Në Bizant vepra e tij ishte shumë e popullarizuar dhe e lexuar, ndërsa u shërbeu si model kronistëve të mëvonshëm. Ajo është shkruar në gjuhën popullore greke dhe përkthyer ngjarjet që nga krijimi i botës e deri në vitin 565. Për hartimin e saj Malala përdori burime të ndryshme historike, kryesisht të kohës romake, por jo në mënyrë kritike. Këngët, dramat dhe mitet për të ishin dokumente të një rëndësie të njëjtë, sikurse veprat e kronistëve dhe të historiografëve. Për ngjarjet e viteve të fundit të shek. V dhe ato të shek. VI u mbështet në tregimet gojore të bashkëkohësve të tij. Vepra e Malalës ka shënime me vlerë për ngjarjet në Ilirik në shekujt e parë të mesjetës së hershme, ku, midis tjerash, zënë vend njoftimet për perandorin Justinian I, për sulmin e hunëve dhe të sllavëve (shek. VI) etj. (Qerim Dalipi)

MALARIA. Është sëmundje ngjitëse, që shkaktohet nga paraziti njëqelizor i gjinisë plazmodium. Njihen rreth 50 lloje të plazmodiumeve dhe 4 prej tyre janë patogjene për njeriun: malarie, vivax, falciparum dhe ovale. Periudha e inkubacionit është mjaft variabile: plazmodium vivax dhe falciparum 7-14 ditë, kurse plazmodium malarie 7-30 ditë, pas së cilës fillojnë shenjat e sëmundjes me ethe, dridhje, temperaturë 39-40°C, vjellje, shpejtimit pulsi etj.

Sëmundja bartet te njeriu përmes pickimit të mushkonjës femër *Anopheles* të infektuar. I sëmuri jo mirë i trajtuar mbetet infektioz deri në 3 vjet për plazmodium malarie, 1-2 vjet për plazmodium vivax dhe më pak se 1 vjet për plazmodium falciparum. Më 1638 Countess d'El Chinchou, gruaja e mbretit të Perusë është mjekuar nga malaria me kininë, e cila u përdor për më shumë se 350 vjet për mjekimin e sëmundjes. Sot malaria është tërhequr në zonat e caktuara gjeografike: tropikale, subtropikale dhe ato me klimë të butë. Në Kosovë në vitin 1946 janë regjistruar 90,000 raste të malaries, që do të thotë se çdo i shtati banor i kohës vuante nga kjo sëmundje ngjithëse. Me programe nacionale për zhdukjen e malaries bëri që kjo sëmundje të eliminohet, prandaj që nga vitit 1971 në Kosovë nuk ka asnjë rast të malaries autoktone. Rrezik permanent paraqesin rastet e malaries së importuar nga zonat endemike dhe hiperepidemike nga kontinenti i Afrikës, duke pasur parasysh popullacionin e madh të mushkonjave anofeles në Kosovë. (Isme Humolli)

MALAZEZISHTJA. Varietet standard i serbo-kroatishtes që përdoret nga malazezët dhe është gjuha zyrtare e Malit të Zi. Malazezishtja standarde është e bazuar në dialektin shtokavian ijekav. Gjuha e Malit të Zi historikisht dhe tradicionalisht është quajtur gjuhë serbe. Ideja e një gjuhe malazeze standarde të veçantë nga serbishtja u shfaq nga ithtarët e pavarësisë së Malit të Zi në vitin 2000, pas pavarësimit të Malit të Zi nga Serbia. Malazezishtja u bë gjuhë zyrtare e Malit të Zi me kushtetutën e vitit 2007. Gjuha standarde e Malit të Zi është ende në zhvillim e sipër. Ortografia e saj u themelua më 2009, me shtimin e dy shkronjave në alfabetin e malazezishtes *š* dhe *ž*, të cilat do t'i zëvendësonin dyshkronjëshat *sj* dhe *zj*. Shkruhet me alfabetin latin dhe me alfabetin cirilik. (Kadire Binaj)

MALET E JUNIKUT. Kompleks malor, që përbën pjesën periferike perëndimore të Dukagjinit dhe të Kosovës. Janë vazhdim i drejtpërdrejtë orografik dhe strukturor i Bjeshkëve të Nemuna. Bashkë me malin e Strelcit (2,377 m), Koproanikun (2,460 m), Zhlebin (2,365 m), Rusolinë (2,381 m) dhe Mokrën (2,154 m) përbëjnë grupin e maleve të Bjeshkëve të Nemuna. Malet e Junikut (me



PAMJE E MALEVE TË JUNIKUT

majën Rrasa e Zogut me lartësi 2,350 m), në skajin jugperëndimor të Bjeshkëve të Nemuna të Kosovës, në vazhdimin juglindor të malit të Gjeravicës (2,656 m), përgjatë kufirit Kosovë-Shqipëri zënë vend midis luginës së rrjedhës së sipërme të Erenikut, në veriperëndim të Qafës së Morinës. Këto male janë formuar nga shkëmbinj të metamorfikë kristalorë e sedimentarë të paleozoit dhe mesozoit dhe më pak nga gëlqerorët e dolomitët, ku gjejmë forma të relievit fluvial, të akullnajave dhe ato karstike. Gjurmët e akullnajave i hasim mbi lartësinë 1,500 m. Malet e Junikut kanë reliev të mprehtë alpin, me shpate të modeluar nga ngricat dhe ujërat e borës që përfundojnë në cirqet dhe lugjet e akullnajave. Malet e Junikut janë një nga zonat pyjore më të mëdha dhe më të pasura jo vetëm në Kosovë, por edhe në Ballkan. Në lartësitë 1,000-1,700 m shtrihet brezi i drurëve gjetherënës (dushk, ah, gështenjë); në lartësitë 1,700-2,000 m shtrihet brezi i halorëve (rrobulli, arneni, pisha e zezë, pisha e bardhë, dëllinja); në pjesët më të larta kërleka (pishë xhuxhe shumë e rrallë); në lartësitë 2,000-2,300 m brezi i livadheve dhe i kullotave alpine; kurse majat më të larta mbi 2,400 m janë të zhveshura nga bimësia. Në Bjeshkët e Junikut jetojnë shumë kafshë të egra: ariu i murrmë, ujku, rrëqebulli, shqarthe i bardhë, derri i egër, kaprolli, pula e gjeli i egër, thëllëza e malit. Klima është alpine, me dimra të gjatë e të ashpër dhe vera të freskëta e të shkurtra. (Nesim Vala)

MALET E NERODIMES. Shtrihen në pjesën jugperëndimore të Fushës së Kosovës, përkatësisht në veri të Maleve të Sharrit dhe kufizohen me lumin Nerodime në jug, Fushën e Kosovës në lindje dhe lumin e Topillës në veriperëndim. Në aspektin gjeologjik përbëhen kryesisht nga shkëmbinj të metamorfikë (rreshe epidotit-kloritike, filite) të moshës së paleozoit dhe gëlqerorë të mesozoit. Lartësia mbidetare e maleve të Nerodimes arrin deri në 1,723 m. Relievi karakterizohet me vlera të larta të copëzimit vertikal dhe horizontal. Temperatura mesatare vjetore luhetet ndërmjet 6-8°C, kurse reshjet vjetore ndërmjet 1,000-1,100 mm. Në malet e Nerodimes hasen burime ujore të tipit të çarshmërisë. Në pjesën perëndimore gjendet kyçi hidrografik i Gadishullit Ballkanik (Suka e Dërmanit). Lumenjtë që rrjedhin në këto anë janë: Nerodimja me degët e saj, si dhe disa degë të lumit Lepenc dhe Toplluhë. Bimësia karakterizohet me pyjet e dushkut në lartësi 700-900 m, kurse mbi 900 haset kati i ahut. Një pjesë e madhe e bimësisë natyrore është degraduar. (Valbon Bytyçi)

MALËSIA E GJAKOVËS. Trevë etnogeografike në verilindje të Shqipërisë dhe në jugperëndim të Kosovës, që përfshin rrethinën e Tropojës dhe pjesërisht komunën e Gjakovës. Kufizohet në verilindje dhe lindje me Kosovën, në jug me Hasin (rrethi i Kukësit), në jugperëndim me Krahinën e Pukës, me të cilën e ndan lumi Drin nga Dukagjini i Vjetër dhe në perëndim e veriperëndim e ndan një vargmal nga Dukagjini i Ri. Bashkësi territoriale etnike, me unitet dialektor dhe historik, e banuar nga fiset: Gash, Krasniq, Bytyç, Mertur (Berisha) dhe më pak Kelmend. Ky grup i krahinave ka si bazë zonën që në gjeografi njihet me emrin Alpet e Veriut, e cila shprehet me toponimin Malësia e Gjakovës (Malësia e Vogël). Malësia e Shkodrës, si Malësia e Madhe dhe Malësia e Gjakovës, si Malësia e Vogël, kanë ruajtur për shumë kohë cilësimet në bazë të qendrave ku ato gravitonin. Në morfologjinë relievo kanë ndikuar lëvizjet tektonike dhe përbërja gjeologjike. Është krahinë gjeografike ndër më të lartat (maja e Shkëlzenit 2,407 m) dhe më shkëmborja në Ballkan. Në përbërje të kodrave dhe majave marrin pjesë gëlqerorët e dolomitët, të shoqëruara me lugina, cirqe e liqene akullnajore. Bimësia përfaqësohet nga zona e dushkut, ahut, pishës dhe kullotat alpine. Këtë reliev të ashpër, me veçanti trajtash

tektonike, me dimra të fortë me reshje bore, e përshkojnë lumenjtë Drini, Valbona, lumi i Tropojës, luginat e të cilëve tradicionalisht kanë shërbyer si rrugë të përshtatshme komunikimi. Karvanët niseshin nga Gjakova në drejtimin Qafës së Morinës (567 m), pastaj Tropojë-Bajram Curr-Shkodër-Vau i Dejës-Pukë-Lezhë, deri në bregdetin Adriatik. Me zhvillimet politike dhe ekonomike të shek. XX dhe me ndërtimin e hidrocentraleve Koman-Liqeni i Fierzës dhe të Vau i Dejës, kjo rrugë humbi funksionin e dikurshëm. Së fundi janë hedhur ide për ndërtimin e korridorit rrugor Adriatik-Alpe, i cili do të lidhte Gjakovën nëpërmjet Qafës së Morinës, Tropojës dhe Bajram Currin me Shkodrën dhe Shëngjinin.

Malësia e Gjakovës është zonë blegtorale, e pasur me xehen e kromit, por mbi të gjitha e përshtatshme për turizëm malor. Është atraktive për kafshët e rralla, si: dhia e egër, derri i egër, ariu i murrme, kaprolli, lloje të shumta shpezësh etj. Me lugina e pllaja, është e përshtatshme edhe për bujqësi, veçmas për pemëtari, ndërsa sipër pllajave shtrihen pyjet e dendura të gështenjës dhe të bungut, të ahut, të pishës dhe të bredhit. Bashkë me klimën e përshtatshme malore, bukuritë natyrore e bëjnë këtë krahinë një nga vendet më pitoreske të Shqipërisë dhe të Ballkanit. (Nesim Vala)

MALI BERISHËS. Mal në Kosovën Qendrore, i lartë 1,014 m, me gjatësi 4 km. Shtrihet në pjesën jugperëndimore të fushëgropës së Drenicës. Nga ana veriperëndimore kufizohet me grykën e Llapushnikut, ndërsa në jugperëndim me trevën e Llapushës, në lindje e verilindje me fushëgropën e Drenicës. Ndërtohet nga formacionet e flishit të kretakut, ndërsa pjesët më të larta nga rreshet filitike. Është diferencuar në formë të një blloku malor nga lëvizjet tektonike vertikale, ndaj fushëgropës së Drenicës dhe Llapushës. Karakterizohet me bimësi të zhvilluar, kryesisht me dushk. (Shejtim Bulliqi)

MALI MILANOVCIT. Mal në lindje të fushës së Dukagjinit, në verilindje të Rahovecit. Në aspektin tektonik paraqet strukturë horstike në mes të Rrafshit të Dukagjinit dhe basenit të Mirushës. Ka shtrirje juglindje-veriperëndim me gjatësi dhe gjerësi 3 km, ndërsa lartësia mbidetare deri 856 m. Në aspektin tektonik i takon zonës së Mirëditës. Ndërtohet kryesisht

nga shkëmbinjtë gëlqerorë shtresorë me stralle dhe gëlqerorët riforë, shtresorë dhe masivë, të moshës kretak i sipërm. Dominojnë format e relievit karstik (fushat karstike, shpella, hurdhja, skriba etj.). Temperatura mesatare vjetore rreth 9°C, kurse reshjet rreth 700 mm. Për shkak të ndërtimit gjeologjik karbonatik, karakterizohet me hidrografi sipërfaqësore të varfër. Gurrat janë të pranishme në skajet e malit. Hasen tokat rendzina dhe deluviale. Pjesa më e madhe është pa bimësi, ndërsa pjesët e mbuluara janë kryesisht me dushk. (Valbon Bytyçi)

MALI I ZI. Shtet në Evropën Juglindore me sipërfaqe 13.812 km², me popullsi 625.266 banorë (2011) dhe me 194.795 ekonomi familjare. Dendësia e popullsisë sillet rreth 45



PODGORICA

banorë/km². Kryeqendra historike e Malit të Zi është Cetina, ndërsa kryeqyteti është Podgorica. Mali i Zi ka dalje në Detin Adriatik në jugperëndim dhe kufizohet nga Kroacia në jugperëndim, Bosnje-Hercegovina në veriperëndim, Serbia në verilindje, Kosova në lindje dhe Shqipëria në juglindje.

Për të parën herë në burimet historike emri i Malit të Zi përmendet në shekullin XIII. Emri më i vjetër i këtij territori është Dukla (sipas fisit ilir të Dokleatëve) e më pas quhej Zeta, sipas lumit me të njëjtin emër. Ne gjysmën e dytë të shek. XV në këtë hapësirë u formua shteti i quajtur Mali i Zi, me sipërfaqe prej 1.500 km². Me forcimin e Malit të Zi si shtet, sipërfaqja u rrit, kështu që kah fundi i shek. XVIII dhe fillimi i shek. XIX u dyfishua. Në betejën e Grahovës në vitin 1858 Mali i Zi fitoi kufirin me Perandorinë Osmane dhe u rrit për 1.500 km² territore të reja. Më pas, Mali i Zi fitoi pranim ndërkombëtar në Kongresin e Berlinit

më 1878, duke zgjeruar territorin nga juglindja në dëm të viseve shqiptare, duke arritur sipërfaqen 9.475 km². Në fillim të shekullit XX, pas luftërave ballkanike, territori i Malit të Zi u rrit në 14.000 km². Në kuadër të Malit të Zi hyri një pjesë e Sanxhakut të Novi Pazarit, një pjesë e Rrafshit të Dukagjinit, e luginës së lumit Lim, si dhe një pjesë në juglindje të Podgoricës. Mali i Zi ishte principatë dhe më pas mbretëri e pavarur, para aneksimit nga Serbia më 1918. Në këtë vit Mali i Zi humbi statusin e shtetit dhe hyri në përbërjen e Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene, më vonë Mbretëria e Jugosllavisë. Pas Luftës së Dytë Botërore, me formimin e Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë (7.3.1945), Mali i Zi ishte njëra nga gjashtë republikat federative. Atëherë territorit të Malit të Zi iu bashkëngjit Boka e Kotorit. Pas shpartallimit të RFS të Jugosllavisë më 1992, Mali i Zi mbeti në kuadër të Jugosllavisë së reduktuar deri në vitin 2003, e pastaj, së bashku me Serbinë, krijoi bashkësinë Serbia dhe Mali i Zi, e cila pushoi së ekzistuari në vitin 2006. Në referendumin e 21 majit 2006, Mali i Zi u pavarësua dhe fitoi pranim ndërkombëtar.

Mali i Zi karakterizohet me reliev malor që përbëhet kryesisht nga male të larta dhe rrafshnalta, lugina të thella lumore dhe me gropën tektoniko-karstike të Liqenit të Shkodrës. Pjesët lindore dhe qendrore janë më të larta, kurse bregdeti i ngushtë dhe më i ulët që shtrihet prej grykës së Bokës së Kotorit e deri te lumi Buna në kufi me Shqipërinë në gjatësi prej 293 km. Malet më të njohura të Malit të Zi janë: Sinjajevina, Bjellasica, Durmitori, Komovi, Magniku, Llovqeni e Rumia, kurse fushat më të njohura janë: fusha e Podgoricës, e Ulqinit etj. Malet e larta e ndajnë bregdetin e ngushtë prej Ulqinit e deri te Gryka e Kotorit, për të vazhduar kah veriu deri në malin Durmitor, ku gjendet njëra ndër majat më të larta në Malin e Zi (Bobotov Kuk, 2.522 m). Në jug dhe në veri shtrihen malet e larta, të cilat e rrethojnë vendin. Rreth Bokës së Kotorit shtrihen malet karstike të Orientit dhe Llovqenit, kurse rreth tyre fusha karstike e Grahovës dhe e Cetinjes. Klima ndryshon varësisht nga relievi dhe afërsia e detit, prej asaj malore, kontinentale, e ndryshuar mesdhetare dhe mesdhetare në bregdet. Fushëgropat e brendshme kanë klimë specifike, me dimra të ftohtë dhe me borë, ndërsa vera shumë të nxehta dhe të thata. Në Cërkvicë (Boka e Kotorit) bien më së shumti

reshje në Evropë (mbi 5.000 mm). Mali i Zi i ka disa lumenj: Moraça, Limi, Tara, Piva, Zeta, Cemi, Buna etj., të cilët rrjedhin në drejtim të Detit Adriatik dhe Detit të Zi. Është i pasur edhe me liqene. Veçohet Liqeni i Shkodrës i cili i takon Malit të Zi dhe Shqipërisë, që është liqeni më i madh në Siudhesën Ballkanike (391 km²) me prejardhje tektoniko-karstike, i cili njëherësh paraqet kriptodepresion. Dallohen liqenet akullnajore në zonat e larta malore, si: Liqeni i Plavës me prejardhje glaciale-morenike, pastaj Liqeni i Shasit etj., dhe shumë liqene të tjera akullnajore, me vlera të mëdha turistike. Mali i Zi dallohet për fond të vogël të tokës punuese, ndërsa me sipërfaqe të mëdha të kullotave dhe pyjeve. Vendi ka pasuri të mëdha nëntokësore. Veçohet qymyri i murrmë (Plevle), boksiti (Podgoricë), plumb, zink, gëlqeror, mergelë, kripë deti (Ulqin) etj. Mali i Zi është shteti më multinacional në Evropën Juglindore. Përbërja etnike sipas regjistrimit të popullsisë (2011) ishte: 278.865 (45%) malazezë, 178.110 (28,7%) serbë, 53.605 (8,6%) boshnjakë, 30.439 (4,9%) shqiptarë, 20.537 (3,3%) myslimanë (sipas kombësisë), 6.021 (0,9%) kroatë, 5.251 (0,8%) romë, 1.154 (0,2%) jugosllavë, 900 (0,1%) maqedonas dhe 30,547 (4,9%) të tjerë ose të padeklaruar. Sipas strukturës fetare, në Mal të Zi ka pasur 446.858 (72,07%) ortodoksë, 118.477 (19,11%) myslimanë, 21.299 (3,44%) katolikë dhe 27.756 (5,38%) të tjerë ose të padeklaruar. Gjatë periudhës së ish-Jugosllavisë, Mali i Zi arriti nivel të konsiderueshëm të zhvillimit ekonomik. U zhvillua metalurgjia e zezë, me ngjyra, industria metalike, elektrike, ushqimore, e letrës, celulozës etj. Gjatë kësaj kohe si qendra industriale u dallua Podgorica (kombinati i aluminit, industria e makinave), Nikshiqi (hekurana), Cetina (elektroindustria), industria e drurit në disa qytete etj. Nga vitet '60 të shek. XX filloi të zhvillohet turizmi bregdetar dhe malor në zonat rreth Budvës, Shën Stefanit, Ulqinit, Tivarit, Durmitorit etj. Sot ekonomia e Malit të Zi është e bazuar në shërbime dhe ndodhet në transicion drejt ekonomisë së tregut. Në vitin 2009 prodhimi i brendshëm bruto ishte rreth 4 miliardë dollarë. (Nail Draga)

MALIQAJ Florim (1988-). Gazetar i sportit. Lindi në fshatin Zabërgjë të Klinës. Kreu studimet për gazetari në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës. Nisi

punën si gazetar i sportit në vitin 2009, si korrespondent nga Klina i gazetës "Sport" dhe më pas në gazetën "Topi", ndërsa punonte edhe në të përditshmen "Zëri" si gazetar i sportit. Në vitet 2011-2012 ishte kryeredaktor i gazetës së studentëve të Universitetit të Prishtinës, "Bota e re". Një kohë punoi edhe për gazetën "Lajm" për revistën javore "IP Magazinë" dhe për portalin "Publiku.net" dhe më pas në gazetën sportive "Sport plus". (Ejup Llumnica)

MALIQI Afrim (1965-1998). Gazetar, poet. Lindi në Dobratin të Podujevës. Shkollën fillore e kreu në Dobratin dhe Dumnicë, të mesmen në Podujevë, kurse studimet për letërsi dhe gjuhë shqipe në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës (1991). Po në këtë kohë filloi të botonte shkrimet e para në gazetën "Bota e re", "Flaka e vëllazërimit" dhe "Zëri i rinisë". Në vitin 1992 punoi arsimtar në shkollën fillore "Naim Frashëri" të Podujevës, ndërsa nga viti 1994 ishte gazetar në të përditshmen "Bujku" në Prishtinë. Me fillimin e luftës në Kosovë u përfshi në organizimin e rezistencës së armatosur në malet e Llapit. Më 2 dhjetor 1998 u vra në Prishtinë nga forcat ushtarake dhe policore serbe, bashkë me Hyzri Tallën dhe Ilir Durmishin. Ka të botuara një vëllim me poezi ("Mbi dritaren time perde mos lëshoni") dhe një libër me recensione, ese, analiza e vështrime për çështje kulturore e politike, për libra dhe fenomene të ndryshme artistike. (Shefqet Rexhepi)

MALIQI Halit (1941-2000). Ekspert i energjetikës, ligjërues. Lindi në Gjilan. Kreu shkollimin fillor dhe të mesëm në vendlindje, studimet në Fakultetin Elektroteknik të Universitetit të Beogradit, ndërsa studimet pasuniversitare në Universitetin e Zagrebit. Ishte njëri ndër inxhinierët e parë shqiptarë i punësuar në kombinatin "Kosova" në Obiliq (1965), ku punoi në punë profesionale, hulumtuese e zhvillimore, në repartet e gjenerimit, në Institutin "Inkos", në drejtorinë e përgjithshme, në departamentin e bartjes-transmisionit të energjisë, në postin e drejtorit të dispeçingut për të dhënë kontribut të çmueshëm në formimin, zhvillimin dhe drejtimin e Elektroekonomisë së Kosovës, përkatësisht të Korporatës Elektroenergjetike të Kosovës. Ishte i angazhuar edhe në procesin mësimor, si asistent i Fakultetit Teknik të Universitetit të Prishtinës për lëndën bazat

e elektroteknikës dhe më pastaj si ligjërues i lartë për lëndët: fushat elektromagnetike dhe ngasjet elektromotorike (1975-1980). Publikoi disa punime nga lëmi i makinave elektrike. (Ali Hamiti).

MALIQI Rashit (1950-). Fizikan, profesor universiteti. Lindi në fshatin Busavatë, komuna e Kamenicës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, shkollën e mesme në Kamenicë. Kreu studimet në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore (FSHMN) të Universitetit të Prishtinës (UP) në vitin 1975. Punoi mësimdhënës i fizikës në gjimnazin e Kamenicës (1971-1977), më pastaj u zgjodh asistent në degën e fizikës të FSHMN-së. Në vitet vijuese ngrihet në titujt përkatës universitarë. Studimet pasuniversitare i kreu në FSHMN të Universitetit të Zagrebit (1981) dhe tezën e disertacionit të doktoratës e punoi në lëmin e gjysmëpërçuesve në Qendrën për Studime Multidisciplinare në Universitetin e Beogradit dhe e mbrojti në FSHMN të UP-së. (1986). (Zahadin Shemsedini)

MALIQI Sheh Hilmi (1865-1928). Hoxhë, sheh, poet dhe përkthyes. Njihet ndryshe me emrat Mulla Mala, Mulla Maliqi apo sheh Mala. "Hilmi" është pseudonim i tij letrar dhe poetik, me të cilin u bë i njohur. Lindi në Rahovec. Studioi në Medresenë "Mehmet Pasha" të Prizrenit". Pasi u kthye në Rahovec, ndërtoi Teqenë e Melaminjve (1887). Përveç predikimeve dhe mësimëve në teqe, zhvilloi edhe një veprimtari të gjerë letrare. Dha kontribut në arsimimin e të rinjve në gjuhën amtare shqipe. Konsiderohet si njëri ndër përfaqësuesit kryesorë të letërsisë së bejtexhinjve në Kosovë. Përveç krijimtarisë origjinale, bëri edhe përkthime nga arabishtja dhe persishtja në gjuhën shqipe dhe turke. Në prozë ka shkruar disa "risale", si: "Fillesa e kitabi ezel", "Sofra e hazreti Alisë", "Lulishtja e Hilmisë qoftë makbuli i Perëndisë", "Bejtullahi hakiki", "Minderlëku i nuseve të hakikatit". Është autor edhe i një divani, që konsiderohet kryevepra e tij. Ka shkruar edhe një "Alfabetare", një vepër didaktike me 29 shenja të alfabetit arab. Ka shkruar dhe ka përkthyer edhe në gjuhën turke dhe arabe. (Jahja Hondozi)

MALIQI Shkëlzen (1947-). Publicist, aktivist i shoqërisë civile, kritik arti. Lindi në Ra-



SHKËLZEN MALIQI

hovec, ndërsa studimet i mbaroi në Universitetin e Beogradit. Pas studimeve një kohë punoi në katedrën e albanologjisë në Beograd. Me t'u kthyer në Kosovë (1982) punoi në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, pastaj ishte redaktor dhe kryeredaktor i revistës "Fjala" dhe zyrtar në BVI-në Kulturore-Arsimore të Kosovës. Po në atë kohë filloi aktivitetin në fushën e publicistikës, ndërkaq në fillim të viteve '90 u përfshi në lëvizjet politike të asaj periudhe. Më vonë u shqua në aktivitetet politike dhe kulturore të shoqërisë civile (Fondacioni Soros, Qendra për Studime Humanistike "Gani Bobi"). Në fushën e gazetarisë punoi si redaktor, columnist dhe gazetar në shumë revista, media elektronike dhe të përditshme vendore dhe ndërkombëtare. Është autor i shumë shkrimeve publicistike dhe i disa veprave nga fusha e publicistikës politike në të cilat u bëhet analizë zhvillimeve në ish-Jugosllavi dhe në Kosovë në periudhën e krizës jugosllave dhe të rënies së socializmit, të luftërave të përgjakshme dhe të transicionit të mëvonshëm ("Nyja e Kosovës", "Shqiptarët dhe Europa", "Shembja e Jugosllavisë" etj.). Një numër shkrimesh të Sh. Maliqit janë përkthyer edhe në gjuhë të huaja. Nga fusha e arteve pamore, Sh. Maliqi është autor i një studimi për artin bizantin ("Estetika e arealit bizantin"), i një sërë shkrimesh eseistike për autorë të ndryshëm dhe për fenomene estetike të kësaj fushe, si dhe i dy monografive (për J. Ferrin dhe S. Shirokën). Ka bërë edhe përkthimin e disa veprave letrare dhe të shkrimeve të ndryshme të autorëve shqiptarë në serbisht (A. Podrimja, B. Hysa, V. Kikaj, I. Kadare, B. Shehu etj.) (Anton K. Berishaj)

MALISHEVA. Qytezë në qendër të Kosovës, që shtrihet në luginën e lumit Mirusha, në lartësi mbidetare 540 m. Ndodhet në kryqëzimin e rrugëve Rahovec-Prishtinë-Duhle-Klinë. Është qendër administrative komunale. Rëndësia e Malishevës si vendbanim rritet me asfaltimin e rrugës Duhël-Malishevë-Kijevë në vitin 1987, e cila lidh magjistralen Prishtinë-Prizren dhe atë Prishtinë-Pejë-Gjakovë. Me ndërtimin e kësaj rruge Malisheva bëhet qendër lidhëse ndërmjet komunave të tjera si Drenas-



MALISHEVA

Suharekë-Prizren. Malisheva ka mikropozitë relativisht të mirë gjeografike, ngase ndodhet në qendër të territorit të komunës, në të cilën kanë qasje të lehtë të gjitha vendbanimet rurale përreth saj, ndërsa vendbanimi më i largët në territorin e komunës nuk është më shumë se 20 km. Malisheva tani ka qasje të mirë edhe në Autostradën Durrës-Prishtinë, e cila kalon vetëm 3 km larg qendrës së qytezës. Sipërfaqja e Malishevës është 841 ha. Vendbanimi ka rrënjë të vjetra që nga koha e antikitetit. Në qendër të vendbanimit, te vendi i quajtur Gumurë, janë gjetur tuma ilire. Përveç këtij lokaliteti, gjurmë të banimit të hershëm hasen edhe në perëndim të Malishevës, në drejtim të fshatit Dragobil. Në defterin e Sanxhakut të Prizrenit (1530) përmendet me emrin Marisheva me 6 shtëpi, ndërsa me emrin Malisheva është regjistruar në një hartë austriake të vitit 1689. Derisa në vitin 1921 Malisheva kishte vetëm 277 banorë, në vitin 2011 u regjistruan 3,395 banorë. Banorët e kësaj qyteze burimet kryesore të të ardhurave i sigurojnë kryesisht nga tregtia (biznesi privat), nga bujqësia (forma e ekonomive familjare me prona të vogla bujqësore), nga sektori shërbyes, arsimit etj. Nga objektet e standardit shoqëror, qyteza ka shkollën fillore, gjimnazin dhe shkollën e mesme profesionale, shtëpinë e shëndetit, njësi tregtare, objekte shërbyese etj. (Bajram Kafexholli)

MALISHEVA (komuna). Komunë në pjesën qendrore të Republikës së Kosovës. Sipërfaqja e komunës është 306 km², në të cilën jetojnë 54,613 banorë të shpërndarë në 44 vendbanime. Dendësia e popullsisë është 178 b/km². Shtrihet në anën lindore të Rrafshit të Dukagjinit. Në veri kufizohet me komunën e Kli-

nës dhe të Drenasit, në lindje me komunën e Lipjanit, në jug me komunën e Suharekës, kurse në perëndim me Rahovecin. Territori i komunës është i rrethuar me male të lartësisë mesatare. Nga format më të shprehura të relievit të Malishevës janë mali Gajrak (769 m) dhe Kullota e Goleshit (636,5m), pastaj fushat e gjëra të Dubravës (Mirushës) të mbjella me drithëra dhe vreshta. Pozita qendrore në territorin e Kosovës e bën këtë hapësirë transite dhe të përshtatshme për qarkullim, meqë këtu kryqëzohen rrugët të rëndësishme, sidomos ato që lidhin komunat: Suharekë, Rahovec, Klinë dhe Drenas. Përmes këtyre rrugëve Malisheva lidhet me qendrat e tjera të Kosovës. Dominon klima e mesme kontinentale me elemente të klimës mesdhetare. Temperatura mesatare vjetore e ajrit është 11°C. Muajt me të nxehtë janë korriku dhe gushti me temperaturë mesatare prej 24.6°C, ndërsa muaji më i ftohtë është janari me temperaturë mesatare -1°C. Territori i komunës së Malishevës ka rrjet hidrografik relativisht të dendur. Lumi Mirusha, i cili buron në malet e Bllacës (masivi malor i Carralevës), kalon nëpër qytezën e Malishevës. Gjatësia e rrjedhjes së tij brenda territorit të komunës është 21.6 km. Regjimi i pavoluitshëm hidrologjik manifestohet në lëkundjet e theksuara të prurjeve gjatë muajve dhe stinëve të vitit. Nga 38 degët e lumit, shumica prej tyre gjatë stinës së verës shteren pjesërisht ose tërësisht. Në anën e djathtë të lumit Mirusha, në fshatin Banjë ndodhet burimi i ujit termal me prurje 120 l/sek dhe me temperaturë të ujit 22° C. Në aspektin ekonomik konsiderohet komunë e pazhvilluar, ku dominon bujqësia. Kultivohen drithërat, perimet, bimët foragjere etj. Ka rreth 11,600 ha sipërfaqe të punueshme dhe rreth 14,800 ha pyje e kullosa. Pjesa më madhe e sipërfaqeve të punueshme është në pronësi private. Rreth gjysma e sipërfaqeve me pyje janë pronë publike, gjysma tjetër i takojnë sektorit privat. Brenda periudhës 1948-2011, popullsia e komunës është rritur për më shumë se tri herë. Derisa në vitin 1948 komuna e Malishevës kishte 17,355 banorë, në vitin 1991 ajo kishte 47,817 banorë dhe në regjistrimin e fundit (2011) komuna ka 54,656 banorë. (Bajram Kafexholli)

MALKOLM (Malcolm) Noel (1956-). Historian britanik. Lindi në Berkshire. Studioi historinë dhe letërsinë angleze në Peterhouse,



NOEL MALCOLM

Kembrixh, dhe mbaroi studimet e doktoraturës në histori në “Trinity College”. Në Kembrixh u mor me jetën dhe veprën e Tomas Hobsit, duke u bërë njëri nga tre redaktorët e një edicioni të ri të veprave të Hobsit (1983). Që në vitet studentore N. Malkolmi filloi të interesohet për historinë dhe kulturën e popujve të Ballkanit. Në vitin 1987 u bë komentues politik në revistën londineze “The Spectator” dhe më pas redaktor i politikës së jashtëm. Në vitin 1989 vizitoi Kosovën për ta ndjekur nga afër shënimin e 600-vjetorit të Betejës së Kosovës në Gazimestan dhe ishte dëshmitar i fjalimit të S. Milosheviqit të mbajtur me atë rast. Në qershor të vitit 1991 ai shkoi në Lubjanë dhe Zagreb, për ta ndjekur nga afër shpalljen e Pavarësisë së Sllovenisë dhe të Kroacisë. Pas shpërthimit të luftës në Bosnjë më 1992, Malkolm-i shkroi shpesh për zhvillimet në atë republikë të ish-Jugosllavisë. Ishte këshilltar i kryeministres Margaret Theçer për Bosnjën dhe Ballkanin. Në vitin 1994 shkroi librin “Bosnja: Një histori e shkurtër”. Libri u vlerësua nga qarqet shkencore dhe politike dhe pati ndikim në vendimet e krerëve botërorë për t’i dhënë fund luftës në Bosnjë. Më pas një kohë të shkurtër punoi si analist politik në të përditshmen britanike “Telegraf”. Në këtë kohë filloi projektin për një libër historie për Kosovën. Gjurmoi arkivat në Bolonjë, Londër, Oksford, Paris, Vatikan, Venedik, Vjenë dhe Uashington. Libri “Kosova: Një histori e shkurtër” u botua në vitin 1998. Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Serbisë reagoi ashpër për këtë botim, duke nxjerrë një vëllim punimesh që sulmonin librin. Libri mbi Kosovën u përkthye në shqip, italisht, turqisht dhe bullgarisht. Në vitin 2001 N. Malkolm u bë anëtar i Akademisë Britanike, më 2002 u zgjodh hulumtues i lartë në “All Souls College” në Oksford. Po në atë vit botoi një përmbledhje të shkrimeve të tij mbi jetën dhe mendimin e Tomas Hobsit. Më pas, si bashkautor, botoi një libër për matematikanin Xhon Pell (1611-1685), ndërsa në vitin 2012 botoi edicionin e tij për traktatin e filozofisë politike të Hobsit, “Leviathan”. Libri i tij më i ri “Agjentët e Perandorisë” (2015) ka për subjekt një familje deri më tani të panjohur shqiptare nga Ulqini,

anëtarët e së cilës luajtën rol të rëndësishëm në historinë e disa shteteve europiane gjatë shekullit XVI. Në vitin 1999 N. Malkolm u bë kryetar i Shoqatës Shqiptaro-Angeleze. Më 2009, kur avokati ndërkombëtar me origjinë britanike, sër Majkëll Vud (Sir Michael Wood) organizoi mbrojtjen e Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë në Hagë, N. Malkolm ishte këshilltar i tij. Në vitin 2004 N. Malkolm u zgjodh anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Është bartës i shumë mirënjohjeve dhe dekoratave. Jeton në Oksford. (Melanie McDonagh)

MALOKI Krist (1900-1972). Shkrimtar. Lindi në Prizren e vdiq në Grac (Austri), vend në të cilin studioi, u doktorua e punoi deri në fund të jetës. Maloki studioi për filozofi e drejtësi.



KRIST MALOKI

Mësimet fillore i mbaroi në vendlindje, në shkollën katolike të Prizrenit. Me bursë u dërgua në Austri, për t’i ndjekur mësimet në shkollën e mesme. Ndoqi studimet në Salcburg, në Vjenë dhe në Grac. Ishte profesor i rregullt i Akademisë Tregtare të Gracit, si dhe profesor i letërsisë shqipe e ballkanike. Tekstet më të njohura të K. Malokit janë “Naim Frashëri” (1925), “Oriental apor Okcidental” (1937), “A asht Poet Lasgush Poradeci?” (Pjesa e parë, 1938, Pjesa e dytë, 1944) etj. Kritika letrare e Malokit, e lidhur në tekstet “Naim Frashëri” dhe “A asht Poet Lasgush Poradeci?” e provon kritikën me rrënjë në filozofi, teori të kulturës e në psikanalizë, pra në diskursin për gjenezën e veprës, të artikuluar me shenja programatike. Në diskursin e tillë autorët e mëdhenj Naim Frashëri e Lasgush Poradeci skajohen si fenomene letrare e kulturore. Ndërsa eseja e njohur e Malokit “Oriental apor Okcidental” lidhet në temën e në debatin e madh shqiptar për identitetin oriental apo oksidental të shqiptarëve bashkëkohës. Siç e provon Maloki, orientalizmi dhe oksidentalizmi shqiptar nuk kanë të bëjnë me moshën e breza, por me mënyrën e jetës e të sjelljes që reflektojnë mendësi, madje një filozofi. Kritika letrare e esetë e Malokit lidhen me tema të mëdha të debatit shqiptar të epokës së tij. (Kujtim M. Shala)

MALOKU Enver (1954-1999). Gazetar. Lindi në Bradash të Podujevës. Shkollën fillore e kreu në Bradash e Bajçinë, gjimnazin në Podujevë, ndërsa studimet për letërsi dhe gjuhë shqipe



ENVER MALOKU

i kreu në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Një kohë punoi arsimtar në shkollën fillore të Bradashit, kurse në periudhën 1979-1990 punoi në Televizionin e Prishtinës. Punoi edhe korrespondent nga Prishtina për botime të ndryshme të diasporës, ndërsa nga viti 1993 ishte udhëheqës i Qendrës për Informim të Kosovës (QIK). Në vitin 1998 themeloi gazetën e parë të mbrëmjes në Kosovë, "Informatori". Themeloi edhe Press-Qendrën e QIK-ut. Gjatë punës së tij u përball me kërcënime dhe sulme të ndryshme. Në korrik të vitit 1998 i shpëtoi një atentati. Nuk arriti t'i shpëtonte atentatit të dytë pasditen e 11 janarit 1999, pak metra larg banesës së tij në lagjen "Kodra e Diellit" në Prishtinë. Pak minuta pas atentatit ndërroi jetë në spitalin e Prishtinës. Komentet e botuara në gazetën e mbrëmjes "Informatori" në vitin 2002, u publikuan në librin e titulluar "Gjuha e stuhisë". Në vitin 2004 presidenti i Kosovës, dr. Ibrahim Rugova, e dekoroi me "Medaljen e Artë të Pavarësisë". (Safet Zejnullahu)

MALOKU Fadil (1958-). Sociolog, profesor universiteti. Lindi në Bradash të Podujevës. Shkollën fillore dhe të mesme i mbaroi në Podujevë, studimet në Universitetin e Prishtinës (UP), në Fakultetin Filozofik, në katedrën filozofi-sociologji. Kreu studimet e magistraturës në Universitetin e Zagrebit më 1986, ndërsa tezën e disertacionit të doktoratës e mbrojti në departamentin e sociologjisë të UP-së. Një kohë punoi si ligjërues i lëndës sociologji e përgjithshme në Fakultetin Xehetaro-Metallurgjik në Mitrovicë (1990-2001). Prej vitit 2001 punon si mësimdhënës i lëndëve: sociologji e globalizimit, metodat kuantitative në sociologji, krimi dhe devijimi social etj. në departamentin e sociologjisë të Fakultetit Filozofik



FADIL MALOKU

të UP-së. Është autor i disa veprave, "Veç Zoti na shpëtoi: ditat eseistik-sociologjik" (2009), "Refleksione sociologjike mbi Islamin (2011)", "Refleksione sociologjike mbi shtetësinë dhe raportet ndëretnike" (2011), "Paradigmat sociologjike të transicionit në Kosovë" (2014) etj. Është edhe autor i një numri artikujsh shkencorë të botuar në revista të ndryshme. (Gëzim Selaci)

MALOKU Flamur (1984-). Shkrimtar. Lindi në Plloçicë të Klinës. Kreu shkollimin fillor dhe të mesëm në Klinë dhe Kijevë, ndërsa studimet në degën e letërsisë shqipe të Fakultetit të Filologjisë në Prishtinë, ku i kreu edhe studimet pasuniversitare. Për dy vjet ishte i angazhuar në projektin "Epika legjendare e Rugovës", në kuadër të Institutit Albanologjik në Prishtinë, për të vijuar pastaj punën e redaktorit të kulturës në disa revista periodike. Aktualisht punon në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës dhe është asistent i angazhuar në Fakultetin e Filologjisë. Përveç shkrimeve të shumta nëpër gazeta e revista letrare, ka botuar edhe këto libra: "Shtresimet e tekstit" (kritikë, 2008), "Diskursi dhe shenja" (studim 2009), "Mythosi i jetës" (poezi, 2009), "Nafora" (poezi, 2010), "Polisemia e veprës" (studim, 2013), "Fjala poetike - Antologji e poezisë shqipe në Kosovë" (Nju-Jork, Prishtinë, 2013), "Brymë e zezë" (poezi, 2015). (Zejnullah Rrahmani)

MALOKU Hamit (1933-2006). Gazetar. Lindi në Samadrexhë të Vushtrrisë. Filloren e kreu në fshatin e lindjes, kurse mësimet e mësuesisë i ndoqi në Gjakovë dhe në Pejë. Studimet për gjeografi i kreu në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Beograd, ndërsa gjeografinë e kreu në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Një kohë punoi në arsim. Nga viti 1958 e deri më 1961 punoi në Radio Prishtinë, e më pas në administratën komunale të arsimit në Prishtinë, prej nga kaloi në redaksinë e revistave të "Rilindjes". Për shumë vjet drejtoi gazetën "Bazat e arsimit teknik (BAT)". Kryesisht shkroi tekste për çështjet e arsimit dhe të edukimit tekniko-shkencor në shkolla. (Zenun Çelaj).

MALOKU Hashim (1945-1998). Mjek, patolog, profesor universiteti. Lindi në fshatin Bradash të komunës së Podujevës, shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa gjimnazin



HASHIM MALOKU

anatomia patologjike në Fakultetin e Mjekësisë në Zagreb. Është mjeku i parë patolog i Kosovës. Më 1977 u zgjodh ligjërues në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. Mbrojti temën e doktoratës po në Fakultetin e Mjekësisë më 1979. Më pas u zgjodh docent, profesor inordinar dhe në vitin 1991 mori titullin profesor ordinar. Për përsosje profesionale qëndroi në Typingen të Gjermanisë. Gjatë viteve 1997-1998 ishte dekan i Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës. Me emrin e tij lidhet zhvillimi i Institutit të Anatomisë Patologjike të Fakulteti të Mjekësisë në Prishtinë. Si dekan i Fakultetit të Mjekësisë u angazhua për organizimin mësimor në kushte të jashtëzakonshme dhe për ndihmë popullsisë së zhvendosur nga lufta. Mori pjesë në shumë kongrese e simpoziume dhe publikoi një sërë punimesh shkencore-profesionale, si autor dhe bashkautor. (Lumturije Gashi-Luci)

MALOKU Naim (1958-). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), ushtarak. Lindi në fshatin Llabjan të komunës së Pejës. Në vitin 1976 nisi studimet në Akademinë Ushtarake në Zagreb. Deri në vitin 1985 punoi oficer në ushtrinë jugosllave në Slloveni. Në tetor të atij viti u arrestua me akuzën se kishte mbështetur demonstratat në Kosovë dhe u dënua me katër vjet e gjysmë burg. Në të njëjtën kohë i merren gradat ushtarake dhe u përjashtua nga Armata Jugosllave. Një pjesë të dënimit e vuajti në Slloveni, ndërsa më 14 dhjetor 1988 u amnistua nga organet e sllovene të drejtësisë. Në Lubjanë vazhdoi aktivitetin e tij politik dhe kulturor. Ishte kryetar i Shoqatës kulturore shqiptare “Migjeni”. Në shtator të vitit 1991 iu bashkua luftës çlirimtare të popullit kroat për pavarësi.



NAIM MALOKU

si. Me fillimin e luftës çlirimtare në Kosovë në prill të vitit 1998 u inkuadrua në radhët e UÇK-së në Zonën e Dukagjinit dhe në Rekë të Keqe. Më 25 korrik në luftime në Junik u plagos rëndë. Në janar të vitit 1999, me urdhër të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së u dërgua në Zonën Operative të Dukagjinit, në mbështetje për përgatitje të kuadrove të UÇK-së. Në maj të vitit 1999 u dërgua në Brigadën 138 për luftime në Koshare. Pas përfundimit të luftës u çmobilizua. Në vitin më 2000 formoi Partinë Qendra Liberalëve e Kosovës dhe u zgjodh kryetar i saj. Në të njëjtin vit braktisi këtë parti dhe iu bashkua Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), ku u emërua nënkryetar. Më pas u largua edhe nga AAK-ja dhe kaloi tek Aleanca Kosova e Re dhe në vitin 2016 u kthye sërish në AAK. Në zgjedhjet parlamentare 2001, 2004 dhe 2007 u zgjodh deputet në Parlamentin e Kosovës. (Bedri Muhadri)

MALOKU Niazi (1927-1989). Veprimtar i lëvizjes antifashiste, i dënua në “Procesin e Prizrenit”. Lindi në Gjakovë. Si fëmijë, së bashku me familjen, emigroi në Kukës, pastaj në Tiranë. Shkollën fillore e kreu në Tiranë. Shkollën teknike të Tiranës e ndërpreu për shkak të angazhimit në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare. Pas Luftës së Dytë Botërore kreu Shkollën Politike në Beograd. Mbasi u kthye në Kosovë, shërbeu si zyrtar i lartë në rrethet e Gjakovës, Prizrenit, Pejës, Rahovecit, Kaçanikut dhe Suharekës. Gjatë kësaj kohe u angazhua sidomos në zhvillimin e arsimit dhe zhdukjen e analfabetizimit të popullsisë shqiptare. Ishte drejtor i Shkollës Politike në Prishtinë, si dhe mësimdhënës i lëndës së marksizëm-leninizmit në këtë shkollë. Ishte iniciator i vendosjes së përmendores së heronjve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare në qytetin e Gjakovës, në vendin ku më parë kishte qenë Kisha Ortodokse Serbe. Me këtë rast injoroi udhëzimet nga Beogradi për të mos e rrënuar Kishës Serbe, gjë që i kushtoi me burgosje në dhjetor të vitit 1955. U përfshi në “Procesin e Prizrenit” (1956) dhe u dënua me 12 vjet burg, prej të cilave 7 vjet i vuajti në burgun e Goli Otokut. U rehabilitua pas Plenumit të Brionëve. (Alban Dobruna)

MALOKU Beqir (1892-1985). Aktivist fetar dhe kombëtar. Lindi në Gjakovë. Kreu mejtëpin e xhamisë “Haxhi Ymeri” dhe “Ruzhdien”

në Gjakovë. Mësimet i vazhdoi në Shkup, në shkollën “Dar-ul Mualiminë”. Në vitin 1913, pas pushtimit të Kosovës nga Serbia, u largua në Shqipëri, ku shërbeu në Gardën Shqiptare të Princ Vidit në Durrës. Në vitin 1915 ishte kryesekretar në komunën e Lubizhdës së Hasit (rajoni i Prizrenit). Nga viti 1916-1918 ishte sekretar i parë i financave në Gjakovë. Gjatë Mbretërisë Jugosllave, përveç detyrave zyrtare në Gjakovë, u angazhua edhe me veprimtari shoqërore e kulturore. Kontribuoi në themelimin e Bibliotekën në Gjakovë, njëherësh ishte njëri ndër themeluesit dhe udhëheqësit e Shoqatës bamirëse kulturore “Gajret”. Nga viti 1942 deri në fund të vitit 1943 ishte drejtor i policisë në Prizren, prej ku transferohet në Durrës në po të njëjtën pozitë. Në nëntor të vitit 1944, për t’i ikur hakmarrjes së pushtetit komunist, emigroi jashtë vendit. Një kohë jetoi në Austri, Gjermani, Itali, Egjipt, pastaj në Liban, Siri dhe Turqi. Në vitin 1958, nga Turqia përfundimisht u vendos në Romë. Atje ishte bashkëthemelues i shoqatës “Bashkimi Islamik në Perëndim” (Unione Islamico in Occidente), ku edhe shërbeu si imam. B. Maloku u mor edhe me krijimtari. Ka botuar disa punime me tematikë historike dhe fetare, të cilat janë publikuar në shtypin e diasporës. Në vitet e fundit të jetës së tij botoi librin “Kujtim brezit të ri” (Romë, 1978). Vdiq dhe u varros në Romë. (Alban Dobruna)

MALOKU-GJERGJI Tahire (1960-). Mjeke, ekologe humane, profesor universiteti. Lindi në Bradash të Podujevës, shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Podujevë, ndërsa në vitin 1983 u diplomua në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës. Fillimisht u punësua në Shtëpinë e Shëndetit në Podujevë dhe më pas në departamentin e higjienës në Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik (IKSHPK) në Prishtinë. Studimet pasuniversitare dhe specializimin përkatës i kreu në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë (1991). Mbrojti temën e doktoratës po në Prishtinë (1997). Nga viti 2000 bëhet drejtoreshë e departamentit të ekologjisë humane në IKSHPK dhe mban titullin e profesorit ordinar për lëndën e higjienës në Fakultetin e Mjekësisë. Ka marrë pjesë në disa kongrese e simpoziume si dhe është autore dhe bashkautore e disa punimeve profesionale-shkencore. (Selvete Hoxha-Krasniqi)

MALUSHI Shqipe (1955-). Shkrimtare, gazetarë. Lindi në Pejë. Edukimin fillor dhe të mesëm i mbaroi në vendlindje, studimet për albanologji në Beograd dhe në Universitetin e Nju-Jorkut studioi për “shkencat në artet e lira”. Për më shumë se 15 vjet punoi në Amerikë në kompaninë “Editor & Publisher”, dhe më pas, gjatë krizës kosovare, në vitin 1999 u kthye në Kosovë, duke u përfshirë në projekte të ndryshme të ndihmave për gratë e Kosovës. Me programin e saj për të promovuar dhe ndërtuar paqen, ka qëndruar edhe në Shqipëri, Indi, Liban, Afganistan, Amerikë etj. Është autore e dy librave, “Për ty” (vjersha, 1998), dhe “Dhurata e profetëve” (studim anglisht, 2012). (Femi Cakolli)

MALLTEZI Luan (1946-). Historian medievalist. Lindi në Durrës. U diplomua në Fakultetin Histori-Filologji të Universitetit të Tiranës (1968), ndërsa u doktorua për periudhën e mesjetës. Gjatë viteve 1972-1992 punoi në Institutin e Historisë në Tiranë. Në vitet 1993-1997 ishte drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave të Shtetit dhe drejtor i Arkivit Qendror të Shtetit. L. Malltezi bëri kërkime për dokumente mesjetare të Shqipërisë në arkivat e Venedikut, të Raguzës (Dubrovnikut), të Zarës etj. Opsi i tij shkencor ka dhjetëra studime mbi zhvillimin ekonomik-shoqëror, politik-kulturor të Arbërisë në shek. XII-XV, ndër të cilat veçohen: “Qytetet e bregdetit shqiptar gjatë sundimit venedikas (1392-1478)” (1988) dhe disa vjet me pas botoi studimin “Beteja e Fushë Kosovës dhe shqiptarët (1389)”. Ishte bashkautor në përgatitjen e vëllimeve me dokumente “Dokumente për historinë e Shqipërisë të shek. XV (1400-1405)” (1987), “Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave (1944-1948)” (1996) etj. Një periudhë punoi si historian në ngritjen e Muzeut “Gjergj Kastrioti-Skënderbeu” në Krujë. (Qerim Dalipi)

MAMUSHA. Vendbanim në pjesën jugore të Rrafshit të Dukagjinit, në jug të Kosovës. Është vendbanim i tipit të dendur dhe, që nga viti 2008, qendër administrative e komunës me të njëjtin emër. Shtrihet në lartësi mbidetare 345 m. Sipas regjistrimit të fundit të popullsisë (2011), Mamusha ka 5,507 banorë, me dendësi të popullsisë rreth 500 b/km². Popullsia merret me bujqësi, blegtori, tregti etj. Nga objektet e standardit shoqëror Mamusha ka shkollën



MAMUSHA

fillore, stacionin shëndetësor, disa njësi tregtare dhe të shërbimeve etj. (Idriz Shala)

MAMUSHA (komuna). Komunë në pjesën jugore të Rrafshit të Dukagjinit, në jug të Kosovës. Sipërfaqja e komunës është 11 km². Si njësi e pavarur administrative është e re, e cila u themelua si pilot komunë në vitin 2005, kurse statusin e plotë e fitoi në vitin 2008. Sipas regjistrimit të fundit (2011) në territorin e kësaj komune jetojnë 5,507 banorë, ndaj numrit prej 1,352 banorëve që kishte në vitin 1948. Popullsia merret me bujqësi (54%), tregti dhe zejтари. Mbi 90% të territorit të komunës e zënë tokat bujqësore. Në krahasim me komunat e tjera në Kosovë, Mamusha e ka shkallën më të ulët të papunësisë. Shumica e popullsisë së kësaj komune i takojnë bashkësisë etnike turke. (Idriz Shala)

MAN Stjuart (Edward Stuart Mann) (1905-1986). Gjuhëtar britanik, albanist, indoeuropianist. Studioi në Universitetin e Bristolit. Punoi për krijimin e një fjalori krahasimtar të gjuhëve indoeuropiane.



STJUART MAN

Për studime të shqipes qëndroi dy vjet në Shqipëri (1929-1931), duke punuar si mësues i anglishtes në shkollën e mesme të djemve në Tiranë. Përveç fjalëve nga të folmet e shqipes, ai gjurmoi literaturën e re dhe botimet e hershme. Një kohë studioi në Berlin. Ishte lektor i anglishtes në Universitetin e Bërnos. Udhëtoi nëpër Europë. Në pjesën më të madhe të karrierës së tij, 1947-1972, ishte mësues në shkollën e çekishtes në Shkollën e

Studimeve Sllave dhe të Europës Juglindore në Londër, ku mbajti edhe kurse të shqipes. Për shqipen nisi të botojë që në fund të viteve tridhjetë. Më 1938 shkruante për rotacizmin, ndërsa më 1941 për gjysmëzanoret indoeuropiane në shqipe. Magjistroi më 1941 në fushë të fonologjisë historike të shqipes. Në vitin 1948 botoi versionin përfundimtar të “Fjalorit historik”, dy vjet më vonë artikullin për zanoret indoeuropiane në shqipe, kurse më 1952 artikullin “Bashkëtingëlloret indoeuropiane në shqipen”. Në vitin 1955 botoi studimin “Letërsia shqipe”, kurse dy vjet më pas “Fjalorin anglisht-shqip”. Botoi “Gramatikën historike të shqipes” (1977). Ndërkohë botoi studime për çekishten dhe armenishten dhe “Fjalorin e krahasuar të gjuhëve indoeuropiane”. (Shykrane Gërmizaj)

MANASTIRI I BANJSKËS. Lokalitet arkeologjik afër Zveçanit. Manastiri i Banjskës është ndërtuar në shek. XIV (mes viteve 1313-1316). Gjatë shekullit XX janë bërë disa herë gërmime arkeologjike në këtë lokalitet dhe janë zbuluar objekte të rëndësishme. Më 1915 u bënë gërmime pranë murit jugor të narteksit, me ç’rast u zbulua një varrezë e murosur, në të cilën u gjet një skelet i shtrirë. Në pjesën veriore të kapelës, në fund të një shtrese me tulla është gjetur një skelet, në të cilin ishte e vendosur një unazë masive nga ari. Në pllakën rrethore të unazës së arit është gdhendur një shqiponjë dykrenare dhe rreth qafës së unazës është mbishkrimi “Kush ta mbajë le t’i ndihmojë zoti” (serbisht). Në të njëjtën varrezë është zbuluar edhe një unazë ari, që mendohet se i takonte mbretëreshës Teodora, gruas së dytë të mbretit Stefan Deçani. Me gërmimet e vitit 1930 janë zbuluar mbetje arkeologjike të pragut të portës. Në vitin 1938, gjatë punimeve për konservim në kapelën jugore, është gërmuar apsida. Hulumtimet kanë vazhduar edhe në vitin 1971, ku, ndër të tjera, janë gjetur edhe mbetje të portës së drurit të manastirit. Gërmimet arkeologjike në Banjskë kanë rëndësi të veçantë edhe për faktin se paraqesin një shembull të rrallë të hapjes së varrezave mesjetare, në të cilat ka mbishkrime. (Kujtime Boshtarakaj)

MANASTIRI I DEÇANIT. Kompleksi i Manastirit të Deçanit i takon periudhës së hershme bizantine, ndërsa shpatet përreth janë



MANASTIRI I DEÇANIT

të njohura me kisha dhe shpella eremite ose qeli, po nga kjo periudhë. Manastiri gjendet në brigjet e lumit Bistrica të Deçanit, në juglindje të Pejës dhe konsiderohet si mauzole i mbretit Stefan Deçani (1322-1331), ktitor i manastirit. Pas vdekjes së tij dhe varrosjes në tempull, vazhdimin e ndërtimit e financoi Dushani. Arkitektura, skulpturat dekorative dhe freskat që kanë mbijetuar deri në ditët e sotme, dedikuar Krishtit Pantokrator, konsiderohen si vepra të arkitektit Frat Vita (emri i tij ruhet në një mbishkrim të gdhendur mbi arkitraun e portalit jugor), të skulptorit Miho Tivarasi, të piktorit Sergji, si dhe të ndonjë krijuesi tjetër të arteve figurative. Muratura e Deçanit u realizua në vitet 1327-1335, ndërsa pikturat e freskave gjatë viteve 1343-1348. Ndërtimi është bërë kryesisht sipas stilit romanik e gotik të bregdetit, duke u gërshetuar me elemente të stilit vendor të ndërtimit. Kompleksi i Manastirit të Deçanit konsiderohet objekt sakral më i madhi i rindërtuar dhe ndërtuar në shek. XIV. Manastiri ka trajtën e bazilikës pesëanijatëshe me kube, me disa reminishenca të kryqit, sidomos në bazë, si dhe me narteksin e shenjtëroren trenefëshe. Ka një gjatësi prej 36 m, gjerësi 24 m, dhe lartësi 29 m. Përbëhet nga tri pjesë: pjesa e altarit, naosit dhe pjesës hyrëse (pripratos). Manastiri është ndërtuar me gurë mermeri të latuar, ngjyrë të verdhë dhe të kuqe, të radhitur sipas rripave alternativë. Katër portalet, dritaret, kapitelet dhe kurora e mbuluar e konzolave nën çati janë dekoruar me plastikë të pasur mermeri të stilit romanik e gotik. Dekorimi i brendshëm përfshin kryesisht freskat që mbulojnë të gjitha muret, nga kulmi i kupolës deri në dysheme. Janë ruajtur freskat kryesisht të origjinës bizantine, me elemente të caktuara të antikitetit, të ardhura nga bregdeti.

Sipas tematikës ato përfshijnë gjithë repertorin biblik prej më shumë se 20 ciklesh, me mbi 1,000 karaktere të pikturuara individualisht. Shquhen ciklet “Legjenda mbi Shën Gjergjin”, “Jeta e Virgjreshës”, “Gjykimi Fundit”, “Veprat apostolike” etj.

Duke qenë se mjeshtrit e Deçanit kryesisht vinin nga bregdeti Adriatik, analogji arkitekture dhe skulptura dekorative të tilla mund të ndeshim edhe në Kotorr, Portonovo (te Ravena), Raguzë, Rotec (te Tivari), Shas, Shkodër, Tivar, Ulqin, Vaun e Dejës (Danja mesjetare) etj. Fakti se popullsia e këtyre qyteteve bregdetare (përveç në Portonovo) kryesisht ishte shqiptare e ritit romano-katolik, duhet të ketë ndikuar që edhe shumë mjeshtër të arteve figurative t’i ndeshim si realizues të punëve kryesore edhe në kompleksin e Manastirit të Deçanit. Këto lidhje janë ruajtur edhe në kohën e sundimit të Balshajve, të Dukagjinëve dhe të Kastriotëve në këto anë. Madje në ambiente shoqëruese të Manastirit të Deçanit edhe sot ruhet një llambadar i Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, dhuruar manastirit. Ndikime të përafërta ruhen edhe në kisha romane-katolike të Novobërdës, Trepçës etj.

Nga vitit 2004 Manastiri i Daçanit gjendet në listën e trashëgimisë kulturore të UNESCO-s. (Jahja Drançolli)

MANASTIRI I GRAÇANICËS (shek. IV-XIV). Kisha e Manastirit të Graçanicës është monument fetar ortodoks, që i është kush-tuar “Të ngjiturit të Zonjës”, donator i të cilit ishte Millutini (1321). Kisha, bashkë me Manastirin, gjenden në kuadër të vendbanimit të Graçanicës, afër Prishtinës, përkatësisht afër qytetit antik Ulpiana. Kisha paraqet adaptim apo rindërtim mbi rrënojat, mbi planimetrinë dhe trajtat e një bazilike paleokristiane të shek. IV-VI. Objekti paraqet njërin prej ndërtimeve të rëndësishme, vepra më e bukur arkitekturale e stilit të ritit ortodoks bizantin të mesjetës së vonë në territorin e Kosovës. Kisha u adaptua në dekadën e dytë të shek. XIV. Në këtë objekt kulti pasqyrohet modelimi shkallëzor apo piramidial i masës, i formave dhe i trajtave, ku rolin primar e kanë efektet e jashtme. Për efektet e arritura në eksterier, kryemjeshtri apo arkitekti është dashur që në vend të katër shtyllave në enterier të konstrukttojë edhe disa të tjera, me qëllim të përforcimit dhe të bartjes së krejt strukturës së qemerëve. Kjo mënyrë e



MANASTIRI I GRAÇANICËS

realizimit ka ndikuar në vëllimin e brendshëm të kishës. Ndërtimi është tip i bazilikës me tri anijata, që përfundon me absida trefaqëshe dhe mbulohet me pesë kube. Pos vlerës dhe rëndësisë arkitekturale, ajo veçohet edhe me piktura me përmbajtje fetare të stilit narrativ. Pikturat murale paraqesin një përmbledhje të gjitha tendencave të pikturave, që zhvilloheshin në punëtoritë e piktorëve dhe të shkollave të njohura të rajonit. Pikturat në kishë, përveç për nga madhësia, veçohen edhe me përmbajtjen dhe vlerën artistike. Format e figurave dhe të kompozicioneve në mënyrë mjaft harmonike iu përshtatën proporcioneve të arkitekturës në brendësinë e kishës. Në përgjithësi, pikturat murale në Kishën e Graçanicës, pos tjerash, i karakterizon koloriti i pasur dhe ngjyra e gjallë, si pjesë përbërëse e kompozicioneve të pasura figurative. (Fejaz Drançolli)

MANASTIRI I KORISHËS. Lokalitet arkeologjik, rreth 10 km në verilindje të qytetit të Prizrenit. Hulumtimet e para janë bërë në vitin 1961, me çrast është zbuluar kisha, kthinat e murgjve si dhe objekte të tjera. Manastiri i Korishës ndryshe quhet edhe Kisha e Pjetrit të Korishës (Mrekullibërësit), që sipas burimeve përmendet në shek. XIV (1343). Pjesa më e vjetër e kompleksit të manastirit është shpella në shkëmb. Në këtë shpellë (e cila gjendet në një shkëmb të fshatit Kabash), janë zbuluar gjurmë të kishës. Orientimi i kishës është veri-lindje (absida) dhe jug-perëndim (hyrja). Po ashtu

në kishën e tipit qeli (shpellë) shihen shtresat e freskave, të punuara në shkëmb. Muret e brendshme të shpellës janë të mbuluara me dy shtresa të freskave të kohës më të hershme dhe më të vonë. Mbi freskat e hershme dallohet një shtresë e freskave të mbipunuara, të cilat dallohen si për nga ngjyrat, ashtu edhe për nga teknika e punimit. Në pjesën më të vjetër të manastirit, në dysheme të kishës qeli, është zbuluar një varr, në të cilin mendohet se është varrosur Pjetri i Korishës në shek. XIV. Varrin në dyshemenë e kishës ka qenë i murosur me gurë dhe pllaka gjysmë të përpunuara. Gjatë gërmimeve arkeologjike në fillim të viteve '70 të shek. XX është zbuluar se bëhet fjalë për një varrim të katërfishtë në të njëjtin vend. Varrimi i katërfishtë lë të kuptohet se bëhet fjalë për një vazhdimësi të jetës dhe të kulturës kishtarë nga periudha e krishterimit të hershëm. Në periudhën e mesjetës fshati Kabash u bë një qendër e madhe eremite, në të cilën u ndërtuan shumë manastire, por qendra e tyre edhe në shekujt e mëvonshëm mbeti e njëjtë dhe thuhet se ishte manastiri ku u varros Pjetri i Korishës. (Kujtime Boshtrakaj)

MANASTIRI I STUDENICËS. Lokalitet arkeologjik në fshatin Studenicë, që gjendet 8-9 km në perëndim të Istogut dhe rreth 20 km në verilindje të Pejës. Është i njohur së paku



LOKALITETI ARKEOLOGJIK I STUDENICËS NË ISTOG

nga viti 1908, kur një fshatar, duke gërmuar në rrënojat e Manastirit Studenica, ka ndeshur në një kabanë dhe në mbetje tekstili. Tekstili është dërguar në Patrikanën e Pejës, ndërkaq kambana është vendosur në Kishën Françeskane të Pejës. Raporti i parë profesional për rrënojat e Manastirit të Studenicës (pa gërmime) është bërë në vitin 1936 nga arkitekti Gj. Boshviciq

dhe inxhinieri S. Smirnov, ndërsa gjermime sistematike janë bërë në vitet 1966-1970. Me këto gjermime është dëshmuar se kompleksi mesjetar i manastirit, si seli e Peshkopatës së Hvosnës, pas pushtimeve nemanjide dhe pas vendosjes së organizmit kishtar ortodoks rasian në këto anë (pas vitit 1219) është ndërhyrje mbi një ndërtim të tërësishëm kulturor paleokristian-bizantin (shek. IV-VI) dhe rindërtim gjatë mesjetës së hershme (deri në shek. XI). Nga fundi i shek. XIV, përkatësisht nga viti 1381 kjo seli peshkopale u ngrit në Mitropoli të Kishës Ortodokse të Rashës. Kisha kryesore e manastirit, njënefëshe, është një ndërhyrje pas vitit 1219 mbi bazilikën paleokristiane trinefëshe dhe kishte një absidë altari të madh, nga jashtë katrore, nga brenda gjysmërrethore. Kisha është murosur me sigë të gdhendur nga mjeshtrë bregdetarë romanë. Edhe ndërhyrjet e kryera janë nën ndikimin e romanikës bregdetare, gjë që vërehet sidomos në aplikimin e këndeve të drejta për absida, si dhe në radhitjen e lezeneve këndore, që ndanin ballinat (fasadat). Gjetjet e fragmenteve të shumta nga suvaja dëshmojnë se kisha kishte dekorime freskash. Ndërkaq, sa i përket skulpturës, janë gjetur vetëm disa fragmente. Kisha veriore ishte e vendosur pranë tempullit (faltos) kryesor dhe përbëhej nga naosi njënefësh me absidë gjysmërrethore të altarit, paripratosit (parahyrje) dhe tremit në pjesën perëndimore. Ky duhet të jetë aneksi i bazilikës paleokristiane, i cili në periudhën e mesjetës së vonë është riparuar dhe është dekoruar me freska. Kisha e vendosur në pjesën jugore të kompleksit ka qenë ndërtim njënefësh me absidë gjysmërrethore të altarit dhe gjithashtu kishte dekorime freskash. Rrënojat e bazilikës paleokristiane u takojnë edhe dy varrezat nëntokësore të murosura për shumë njerëz, si dhe qeramika e hershme bizantine. Nga pjesët e tjera të manastirit është zbuluar salla e ngrënies dhe konakët, të vendosur në veri të kishës. Në qendër është vendosur rezervuari i ujit. Shihen gjithashtu gjurmët e murit mbajtës të manastirit, sidomos në pjesën veriore dhe themelet e një kulle katrore, ku mund të ketë qenë dera kryesore. (Jahja Drançolli)

MANASTIRI I SHENJTORËVE MËHILL E GABRIEL, PRIZREN. Lokalitet arkeologjik rreth 3 km në juglindje të Prizrenit. Gjurmët e kompleksit të Manastirit të Shenjtorëve Mëhill



MANASTIRI I SHENJTORËVE MËHILL E GABRIEL, PRIZREN

e Gabriel janë të njohura së paku nga shek. IV-VI të erës sonë. Sipas burimeve serbe, kalaja mbi manastir është quajtur Vishegrad ose “Qyteti i Dushanit”, ndërkaq kompleksi i manastirit është quajtur Shën Arkangjeli. Banorët e vendit e quajnë Kalaja e Cucave. Që të dy emërtimet sllave janë të njohura nga mesi i shek. XIV dhe bartin me vete një pjesë të historisë së dinastisë nemanjide deri në vitin 1371, vit që shënon kalimin e Prizrenit prej duarve nemanjide në duar të dinastive arbërore, përkatësisht të dinastive Balshaj dhe Kastrioti.

Gjatë gjithë shekujve të mesjetës, Kalaja e Cucave ka mbijetuar së bashku me kompleksin e Manastirit të Shenjtorëve Mëhill e Gabriel pothuajse si pjesë integrale e saj. Gjurmët e këtij kompleksi kishtar historikisht mund të ndiqen nga periudha paleokristiane. Nga viti 1927 dhe deri në ditët e sotme në këtë kompleks është zbuluar një kishë paleokristiane e shoqëruar me 5 varre, po të asaj periudhe. Nga hulumtimet e mëvonshme janë zbuluar edhe shtresa kulturore bizantine, nemanjide të kohës së perandorit Dushan. Në këtë periudhë janë bërë rinovime, sidomos në Kishën e Shenjtorëve Mëhill e Gabriel. Janë evidentuar edhe ndërhyrjet në kishëzën paleokristiane, e cila gjendet gjithashtu në kompleksin e manastirit, që i është kushtuar Shën Nikollës. Në kompleksin e shenjtorëve Mëhill e Gabriel nga vitet 1371-1376 është i njohur mauzoleu i Strazimir Balshës, që është ndërtuar afër mauzoleut të Dushanit (1348-1352). Përveç mauzoleut është zbuluar edhe një kokë e gdhendur kushtuar Strazimir Balshës (1372), si pjesë e një skulpture, së cilës i mungon trupi. Së bashku me këtë artefakt, në kohën e Mbretërisë Jugosllave janë bartur në Muzeun e Shkupit

edhe shumë artefakte të tjera, të cilat shënojnë periudhën shqiptare të manastirit. Kohës së Balshajve i takonte edhe një mozaik pothuajse i vetmi në Ballkan i këtij lloji, që i ngjason mozaikut të Pagëzores në Katedralen Santa Maria në Firence. Që nga koha e sundimit të Balshajve, Prizreni ishte bërë qendër e njohur e kishës katolike. Manastiri ishte pjesë përbërëse e Kishës mitropolitane të Prizrenit. Historia e manastirit mund të ndiqet së paku deri në vitin 1519, kohë kur Prizreni tashmë kishte rënë përfundimisht nën osmanët (1459). (Jahja Drançolli)

MANASTIRI Ismail Haki (1846-1912). Di-jetar i shquar, profesor universiteti, publicist, autor i shumë veprave. Lindi në Manastir dhe u bë i njohur me mbiemrin e vendlindjes. Pas mbarimit të shkollës fillore në Manastir, studimet i kreu në Stamboll. U bë i njohur si ligjërues në xhamitë kryesore të Stambollit, si në xhaminë e Fatihut, Dolmabahçes, Sylejmanijes dhe sidomos u shqua për ligjëratat e tij në Xhaminë e Aja Sofisë. Ishte mësimdhënës në disa institucione arsimore në Stamboll, si në Gjymnazin Ushtarak, në Shkollën e Drejtësisë, në Shkollën Inxhinierike, në Shkollën Mjekësore Ushtarake dhe në Universitetin e Stambollit "Darul-funun". Shumë shqiptarë kishin marrë diplomën te ky profesor. Në vitin 1908 u bë anëtar i Dhomës së Parisë (ajanëve) në Parlamentin Osman. Ishte anëtar edhe i Komitetit të Stambollit. Në vitin 1911 Ismail Haki Manastirliu e shoqëroi sulltan Reshatin gjatë vizitës së tij në Kosovë, me ç'rast mbajti edhe ligjëratën e xhumasë. Botoi shumë shkrime në shtypin e kohës. Ishte autor i dhjetëra veprave nga fusha e shkencave islame. Vdiq në Stamboll dhe u varros në oborrin e Xhamisë së Fatihut. (Nehat Krasniqi, Sadik Mehmeti)

MANDALA Mateo (Matteo Mandala) (1958-). Filolog, albanolog, profesor arbëresh. Lindi në Horën e Arbëreshëve, Sicili. U diplomua në Universitetin e Palermos, ku filloi aktivitetin pedagogjik si lektor i gjuhës shqipe (1987), për të vijuar si kërkues shkencor në Universitetin e Pizës, të Kalabrisë (1996), Barit (1997-1998), Leçes (1997-1999), Mesinës (2000-2004) dhe tani është profesor i gjuhës dhe i letërsisë shqipe në Universitetin e Palermos. Studimet e tij shtrihen në fushën e albanologjisë, të traditave kulturore, letrare dhe gjuhësore të arbëreshëve



MATEO MANDALA

të Sicilisë dhe lidhjet me trevat albanofone ballkanike, duke synuar rishkrimin rrënjësor të burimeve letrare e gjuhësore që vijnë nga tradita, me një analizë rigorozë filologjike moderne. Autor i një numri të madh artikujsh, kumtesash e monografish: "Gjurmime filologjike për letërsinë romantike arbëreshë" (2013), "Lekë Matranga: njeriu, koha, vepra" (2013), "Profili historik - antologji e letërsisë së arbëreshëve të Sicilisë" (Profilo storico-antologico della letteratura degli Albanesi di Sicilia, 2012), botim kritik i "Këngës së sprasëme të Balës" (2007), "Mundus vult decipi, I miti della storiografia arbëreshë" (2007), "Il codice chiu-tino di Nicolo' Figlia", botim kritik dhe konkordanca leksikore (1995), botimin e plotë të veprës së Zef Skiroit, (Itali-1998, Kosovë-2001) etj. Puna e tij kërkimore është konkretizuar në disa projekte shkencore për studime historike, gjuhësore dhe etnografike të arbëreshëve në përgjithësi, të arbëreshëve të Sicilisë në veçanti. Është anëtar i një sërë asociacionesh, redaksish të botimeve të veçanta dhe profesionale. Është themelues dhe drejtor i revistës "Res Albanicae" (2011). (Aljula Jubani)

MANDRAPA Olga (1923-?). Aktore. Lindi në Glloklepci të Çaplinës (Bosnjë e Hercegovinë). Në ansamblin e dramës serbe të Teatrit Popullor Krahinor në Prishtinë u pranua si aktore në vitin 1948. Luajti në sfaqje dhe role të ndryshme, nga të cilat veçohen: "Personi i dyshimtë", "Zonja ministreshë", "Banditi Stanko", "Ura", "Nëna Kurajë", "Familja e pikëlluar", "Pop Qira dhe pop Spira", "Maçorri me çizme", "Bota", "Madam San-Zhen", "Përrallën mbi mbretin dhe bariun", "Tregtari i Venedikut", "Ligësitë dubrovnikase", "Armiqtë", "Zjarri dhe bora", "Fizikanët", "Violina magjike", "Zona e Zamfirrit", "E shoqja e Hasan Agës", "Babai", "Procesi", "Orkestra e femrave" etj. Për punën në teatër u vlerësua me çmime dhe mirënjohje. (Bekim Lumi)

MANI Sali (1878-1946). Atdhetar, veprimtar i çështjes kombëtare. Lindi në Bujan të Malësisë së Gjakovës. Mori pjesë në kryengritjen e përgjithshme antiosmane të vitit 1912 dhe

ishte njëri ndër organizatorët kryesor të rezistencës të Krasniqes, Gashit, Bytyçit dhe gjithë Malësisë së Gjakovës kundër forcave serbe e malazeze në vitin 1913. Mori pjesë edhe në përballjet luftarake të forcave të rezistencës edhe kundër trupave austro-hungareze gjatë Luftës së Parë Botërore (1918). Në vitin 1924, gjatë Revolucionit të Qershorit mbajti anën e grupimit politik të afërt me Fan Nolin dhe bashkëpunoi ngushtë me Bajram Currin. Gjatë Luftës së Dytë Botërore përkrahu Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare. Më 31 dhjetor 1943 dhe 1 e 2 janar 1944 në kullën e tij i zhvilloi punimet Konferenca e Bujanit. Pas përfundimit të luftës u zgjodh kryetar i Këshillit të Rrethit të Kukësit dhe deputet i Parlamentit të Shqipërisë. (Frashër Demaj)

MANIFESTIMI KULTUROR “FLAKA E JANARIT”, GJILAN. Manifestim kulturor mbarëkombëtar i themeluar më 1991 nga një grup artistësh fushash të ndryshme, i organizuar për herë të parë më 1992. Koncepti artistik që detyrë e anëtarëve, ai teknik-organizativ i Forumit Rinor të LDK-së, ndërsa qëllimi i manifestimit ishte që përmes veprave letrare, muzikore, skenike dhe pamore të nderohen heronjtë, dëshmorët dhe martirët e luftës për liri në Kosovë. Manifestimi i parë i vitit 1992 lidhej me 10-vjetorin e vrasjes së Jusuf e Bardhosh Gërvallës dhe Kadri Zekës. Programi themelor i manifestimit që nga fillimi kishte karakter garues, me qëllim të nxitjes dhe të afirmimit të vlerave artistike. Në vitet e para manifestimi u organizua në trekëndëshin Përlepnice-Bresalc-Gjilan, ndërsa më vonë u zgjerua në gjithë qendrat e Kosovës dhe jashtë saj, por nuk mbijetoi. Megjithatë, në Gjilan manifestimi vazhdoi punën dhe mbushi 25 vjet punë. Aktivitetet e përvitshme janë: Koncerti i muzikës serioze dhe tribuna tematike, “Talia e Flakës”, Festival i dramës shqipe (“Fest Flaka”), i këngës së traditës (“Folk-Flaka”) i muzikës folklorike (“Xixat e Flakës”), i muzikës për pionierë (“Peneli i Flakës”), ekspozita e artistëve pamorë me shpërblime përkatëse dhe pjesa letrare e manifestimit (“Pena e Flakës”). (Arnisa Rexhepi)

MANIFESTIMI LETRAR “KARVANI I SHKRIMTARËVE PËR FËMIJË ‘AGIM DEVA’”. Është manifestimi më i madh letrar për fëmijë në Kosovë. U themelua në vitin

2000 nga shkrimtari Agim Deva, i cili edhe e udhëhoqi për nëntë vjet me radhë. Tubon shkrimtarët për fëmijë në Kosovë. Në fillim pati synim rehabilitimin e fëmijëve të traumatizuar nga lufta, ndërsa më vonë vazhdoi me takime të shumta me fëmijët kudo në Kosovë dhe në trevat e tjera shqiptare, duke nxitur tek ata dashurinë për librin dhe përkushtimin për krijimtarinë letrare, si dhe duke pasuruar fondin e bibliotekave shkollore me libra të rinj për fëmijë. Në kuadër të manifestimit organizohen edhe tryeza shkencore për çështje të letërsisë për fëmijë. Në aktivitetet e tij angazhon shkrimtarët për fëmijë nga Kosova, por edhe nga trevat e tjera shqiptare. Në fund të çdo manifestimi, Karvani ndan çmimin letrar “Ymer Elshani” për veprën më të mirë për fëmijë të botuar midis dy manifestimeve. (Xhevat Syla)

MANIFESTIMI LETRAR “MITINGU I POEZISË”. Manifestim letrar i themeluar në vitin 1964 nga Klubi letrar “Gjon Nikollë Kazazi” i Gjakovës. Që nga ajo kohë e deri tash,



MANIFESTIMI LETRAR “MITINGU I POEZISË”, GJAKOVË

ky manifestim letrar, që më vonë u pagëzua “Mitingu i poezisë” mbahet çdo vit më 9 maj në qytetin e Gjakovës. Në manifestim marrin pjesë poetë nga të gjitha trevat shqiptare dhe nga bota e jashtme. Është organizuar në bashkëpunim me Shoqatën e Shkrimtarëve të Kosovës, në të cilin, përveç orës së madhe letrare, mbahej edhe tribuna e kritikës letrare, si dhe jepeshin çmimet letrare, si: Shpërblimi i Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës për librin më të mirë të poezisë të botuar ndërmjet dy mitingjeve të poezisë (tash ky çmim ka marrë emrin e poetit Din Mehmeti), “Pena e artë” që e jepte redaksia e revistës letrare “Fjala”,

Çmimi i Klubit letrar “Gjon Nikollë Kazazi” për poezinë më të mirë të lexuar në orë letrare (tash ka marrë emrin e poetit “Ali Podrimja”). Në vitet '80 të shekullit të kaluar jepej edhe çmimi i revistës së të rinjve të Kosovës “Zëri i rinisë” për librin më të mirë të autorëve të rinj, ndërsa pas lufte jepet edhe çmimi “Yllka Domi” (për debutuesen e Mitingut), të cilin e jep Shtëpia Botuese “Fan Noli”. Pas vitit 2006 Shoqata e Shkrimtarëve të Kosovës nuk merr pjesë në organizimin e këtij manifestimi dhe ka themeluar manifestimin e ri letrar me emrin Festivali “Drini poetik”, që mbahet më 8 dhe 9 qershor në Prishtinë, Prizren dhe në Kukës. (Ragip Sylaj)

MANIFESTIMI LETRAR “TAKIMET E GJEÇOVIT”. Manifestim letrar dhe kulturor që mbahet në Zym të Hasit (komuna e Prizrenit), i themeluar më 14 tetor të vitit 1971.



MANIFESTIMI LETRAR “TAKIMET E GJEÇOVIT”, ZYM

Organizohet nga klubi letrar “Shtjefën Gjeçovi” në bashkëpunim me Shoqatën e Shkrimtarëve të Kosovës. Sipas traditës së këtij manifestimi mbahej tryeza letrare për çështje të ndryshme të letërsisë, ora letrare, si dhe jepej çmimi letrar për poezinë më të mirë të lexuar në manifestim. Në vitet e pasluftës ka ndërruar edhe fizionomia e këtij manifestimi letrar. Tashmë mbahet ora letrare “Anton Pashku”. Me këtë rast jepen edhe çmimet: “Atë Shtjefën Gjeçovi”, “Pena e Shtjefën Gjeçovit”, “Pena e Pjetër Bogdanit”, “Pena e Anton Pashkut”, si dhe “Unaza e Katit” (Katarina Josipit). Ky manifestim letrar mbahet çdo vit në muajin tetor. (Ragip Sylaj)

MANXHUKA-KËRЛИU Suzana (1959-). Mjeko, patologe, profesore universiteti. Lindi në Shkup, shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu



SUZANA
MANXHUKA-KËRЛИU

në Prishtinë, Fakultetin e Mjekësisë gjithashtu në Prishtinë (1983). Pas diplomimit u punësua në Institutin e Anatomisë patologjike të Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë. Specializoi në lëmin e anatomisë patologjike në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Zagrebit, ndërsa studimet pasuniversitare i kreu në Prishtinë. Subspecializimin nga patologjia kirurgjikale e përfundoi në Nju-Jork, SHBA. Më 1985 u zgjodh asistente e lëndës së anatomisë patologjike në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë, ndërsa më 1997 mbrojt tezën e doktoratës po në këtë fakultet. Më pas i arrin titujt e tjerë universitarë dhe mban titullin e profesores së rregullt të anatomisë patologjike. Ka kryer detyra me përgjegjësi në institucionet shëndetësore dhe universitare. Është autore dhe bashkautore e një sërë punimesh shkencore dhe profesionale. (Halil Ahmetaj)

MAQEDONIA. Shtet në Gadishullin Ballkanik. Ka një sipërfaqe prej 25,713 km², në të cilën jetojnë 2,044,000 banorë (regjistrimi i vitit 2002). Kryeqytet është Shkupi. U shkëput nga



SHKUPI

ish-Jugosllavia më 15. 9. 1991, ndërsa u pranua në OKB më 8. 4. 1993. Në veri kufizohet me Serbinë dhe Kosovën, në lindje me Bullgarinë, në jug me Greqinë dhe në perëndim me Shqipërinë. Ka pozitë kontinentale, por afërsia e porteve të Durrësit dhe të Selanikut shihet si përparësi për zhvillimin e komunikacionit transit dhe të tregtisë ndërkombëtare. Nëpër kryeqytetin e saj gërshetohen dy korridore të

rëndësishme të rajonit: Korridori VIII (Durrës-Shkup-Burgas) dhe Korridori X (Beograd-Nish-Shkup-Selanik). Relievi është kryesisht malor. Kushte të volitshme për zhvillimin e bujqësisë kanë fushëgropat, si ajo e Pollogut, e Shkupit dhe e Pellagonisë. Maqedoninë e përshkon nga veriu në jug lumi i Vardarit, i cili buron nga lokaliteti Vrutok (683 m) në shpatet lindore të Maleve të Sharrit. Degët kryesore të Vardarit janë: Treska, Pçinja, Bregalnica dhe Lepenci. Sipërfaqja ujëmbledhëse e Vardarit është 20,500 km². Në pjesën jugperëndimore të Maqedonisë ndodhet liqeni i Ohrit dhe i Prespës. Këto liqene janë formuar në gropa tektonike, të cilat janë të ndara mes veti nga mali i Galiçicës. Në pjesën juglindore, në kufi me Greqinë, gjendet liqeni i Dojranit.

Dendësia mesatare e popullsisë së Maqedonisë është rreth 80 b/km². Në pjesët e ultësirave dendësia arrin edhe deri në 100 b/km², ndërsa në zonat malore ajo është rreth 25 b/km². Shqiptarët për nga numri janë bashkësia e dytë në Maqedoni dhe kanë një shtrirje territoriale kompakte. Gjatë gjithë historisë së tyre ishin pjesë përbërëse e tërësisë etnike, duke marrë pjesë në mënyrë aktive në të gjitha proceset dhe lëvizjet kombëtare, politike dhe ekonomike të kombit shqiptar. Numrin e vërtetë të tyre pushteti maqedon gjithnjë e ka fshehur, duke i falsifikuar të dhënat në të gjitha regjistrimet zyrtare të popullsisë. Sot shtrihen në 355 vendbanime, ku pjesa dërrmuese janë të karakterit rural, kryesisht në Maqedoninë Perëndimore. Përveç në anën lindore, në të gjitha anët e tjera kufizohen me rajonet e banuara me shqiptarë: me Shqipërinë, me Kosovën dhe me komunën e Preshevës. Popullsia shqiptare në Maqedoni ka një shtrirje territoriale të pakëputur, duke filluar nga shpatet lindore të Malit të Zi, të Shkupit (Karadaku), fushëgropës së Shkupit, shpatet e Maleve të Sharrit dhe fushës së Pollogut, e deri te liqenet e Ohrit dhe të Prespës. Kufiri etnografik ndërmjet shqiptarëve dhe maqedonasve ndjek rrjedhën e Vardarit, edhe pse oaza të banuara me popullsi shqiptare ka edhe në pjesën lindore të luginës së lumit Vardar. Më tepër shqiptarë në Maqedoni jetojnë në rajonin e Shkupit, pastaj në Tetovë me rrethinë, ku dominojnë (mbi 70%), në Gostivar me rrethinë (mbi 65%), në Dibër me rrethinë (mbi 50%; si qendër urbane rreth 75%), në rrethinat e Strugës dhe të Kërçovës (mbi 50%), të Kumanovës (rreth 40%) etj., ndërsa në numër më të vogël jetojnë në rrethinat e Manastirit, të

Ohrit, të Resnës, të Krushevës, të Velesit etj. Në zonën e qytetit të Shkupit jetojnë rreth 200,000 shqiptarë, ndonëse statistika zyrtare i paraqet më pak për shkak të ndarjeve territoriale-administrative, që shkojnë në dëm të shqiptarëve. Shkupi deri vonë, pas Tiranës, njihej si qendra e dytë urbane për nga numri i shqiptarëve. Sipas Institutit Kartografik të Sofjes të vitit 1903 në kazanë e Shkupit kishte 57.3% shtëpi shqiptare (të tjerat ishin bullgare e serbe dhe pak turke, vllahe e çifute). Këto të dhëna pothuajse përputhen me rezultatet e statistikës turke të viteve 1908-1909, sipas të cilave shqiptarët përbënin 55.5% të popullsisë së gjithëmbarshme të qytetit. Ndërkaq, sipas regjistrimit të vitit 1948, shqiptarët përbënin 1/4 e popullsisë së Shkupit. Më vonë përbërja etnike e qytetit u ndërrua, si pasojë e ardhjes më masive të maqedonasve nga viset e tjera të Maqedonisë, veçanërisht pas tërmetit të vitit 1963 dhe shpërnguljes së shqiptarëve për në Turqi. Në vendbanimet urbane të Maqedonisë jeton 60% e popullsisë. Përqendrimi më i vogël në qytete është i shqiptarëve. Sipas vlerësimit të vitit 1991, vetëm një e treta e shqiptarëve jetonte në qendrat urbane të Maqedonisë (32.8%). Sipas regjistrimit të fundit zyrtar të vitit 2002, në strukturën etnike të popullsisë marrin pjesë maqedonasit me 64.2%, shqiptarët me 25.2%, pastaj vijnë turqit, romët dhe serbët. Popullsia aktive në Maqedoni përbën 42.5% të popullsisë së përgjithshme, ndërsa papunësia është 37.3% e popullsisë aktive.

Në vitet '50 dhe '60 të shekullit të kaluar, Shkupi, përkatësisht Maqedonia, shërbeu si etapë e parë për shpërnguljen e shqiptarëve për në Turqi. Këtu ndërrohej përkatësia kombëtare në atë turke, merreshin pasaportat dhe vizat. Në vitet '80, përmes ish-Federatës Jugosllave, Serbia synoi ta përdorte Maqedoninë si territor provues për kufizimin e rritjes demografike të shqiptarëve, për reduktimin e të drejtave dhe për diskriminim të përgjithshëm të shqiptarëve në Kosovë. Në vitin 2001 u zhvillua një konflikt i armatosur midis pushtetit maqedonas dhe shqiptarëve. Për t'i zbutur tensionet ndëretnike dhe për ta përmirësuar gjendjen e shqiptarëve, në vitin 2004 u nënshkrua Marrëveshja e Ohrit, nën mbikëqyrjen ndërkombëtare. Shumë dispozita të asaj marrëveshjeje ende nuk janë zbatuar. Që nga formimi i shtetit maqedonas, një parti shqiptare gjithnjë është pjesëmarrëse në qeverisjen e vendit.

Në ekonominë e Maqedonisë dominon bujqësia, kryesisht ekstensive. Kultivohen drithërat (gruri, thekra, misri), panxharsheqeri, duhani dhe kulturat mesdhetare. Rëndësi ka pemëtaria (kultivohen mollët) dhe vreshtaria. Rol të rëndësishëm në ekonominë e vendit luan blegtoria e specializuar në prodhimin e qumështit dhe të mishit. Një pjesë e produkteve bujqësore eksportohen. Dallohet industria e nxjerrjes së hekurit. Qymyri i llojit linjit nxirret në Pellagoni, ndërsa energjia përftohet edhe nga sistemi hidroenergjetik i Mavrovës, termocentrali i Manastirit etj. Ka të zhvilluar edhe industrinë e metalurgjisë, të makinave, të tekstilit, të materialit ndërtimor etj. Qendra kryesore politike, ekonomike, kulturore dhe administrative është Shkupi. Projekti megaloman "Shkupi 2014" dhe politika e "maqedonizimit" të Shkupit, e kanë shëmtuar arkitekturën e qendrës. Këtë projekt dhe këtë politikë shqiptarët e përjetojnë si antishqiptare. Manastiri dhe Prilepi janë qendrat kryesore të Pellagonisë, ndërsa Tetova është qendra kryesore e fushës së Pollogut dhe e tërë Maqedonisë Perëndimore. (Hivzi Islami)

MAQEDONISHTJA. Gjuhë sllave e jugut. U zhvillua nga e folmja e fiseve sllave nga pjesët më jugore të Ballkanit. Flitet në Republikën e Maqedonisë, ku është gjuhë zyrtare, dhe në hapësirat përreth. Studiuesit maqedonas buri met e saj i gjejnë qysh te Qirili e Metodi. Gjatë zhvillimit të saj, edhe nga ndikimet e gjuhëve tjera josllave të Ballkanit (të cilat përbëjnë grupin e gjuhëve ballkanike) në maqedonishtë kanë ndodhur ndryshime të mëdha: e ka ndërruar lakimin sintetik me analitik, e ka zhvilluar nyjën e prapme, e ka humbur paskajoren morfologjike, ka krijuar një sistem të veçantë të theksit të fjalës të ngulitur në rrokjen e tretë nga fundi i fjalës etj. Si rezultat i ndryshimeve, maqedonishtja në përgjithësi është formuar në shekullin XV. Maqedonishtja, edhe pse jo zyrtarisht, variantin e standardit të vet e ka filluar me librin e Kërste Petkov Misirkovit "Për çështjet e maqedonishtes" (Za makedonckite raboti), kodifikimi i plotë i standardit të saj u arrit në vitin 1944, kur Republika e Maqedonisë e fitoi subjektivitetin në kuadër të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë. Standardi i maqedonishtes mbështetet në të folmet qendrore maqedonase (Veles-Prilep-Manastir-Kërçovë), që janë pjesë e të folmeve perëndimore, por leksiku i maqedonishtes pasurohet

nga të gjitha dialektet. Sot maqedonishtja ka përdorim në të gjitha sferat e komunikimit, me letërsi dhe me një zhvillim në të gjitha stilet funksionale të saj. (Berton Sulejmani)

MAREVCI Nazmi (1932-). Mësimdhënës dhe veprimtar i kulturës. Lindi në Marec, komuna e Lipjanit, ku kreu edhe shkollën fillore. Kreu progjmnazin, shkollën normale dhe Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prishtinë. Nga viti 1948 punoi si mësues në fshatra të Kaçanikut, të Shtërpçës, të Ferizajt, të Lipjanit, si dhe në shkollën fillore "De Rada" në Ferizaj, ku për shkak të aktivitetit politik, u pushua nga puna. Ishte edhe korrespondent i gazetës "Rilindja" dhe njëri nga themeluesit dhe veprimtarët e teatrit amator, i klubit letrar, i klubit të artistëve figurativë dhe i shoqërisë kulturore-artistike "Kastriotët" në Ferizaj. (Hajrullah Koliqi)

MARKIANO Mikele (Marchianò Michele) (1860-1921). Albanolog, historian i letërsisë, folklorist, përkthyes arbëresh nga Maqi (Machia Albanese) i Kozencës. Lindi në një familje me tradita kulturore. Është botuesi i përmbledhjes së parë të folklorit arbëresh të zbuluar prej tij në Kieut të Kapitanatës, i njohur si Dorëshkrimi ose Kodiku i Kieutit (1736), autor i së cilës njihet arbëreshi Nikollë Filja (Foxha, 1908), si dhe botues i veprës "Vjersha fetare arbëreshe" (Poesie lacre albanesi, Napoli 1908). Dha ndihmesë në fushën e historisë së letërsisë. Studimi i tij "Shqipëria dhe veprat e Joronim de Radës" (L'Albania e l'opera di Girolamo De Rada, Trani 1902) është e para monografi e plotë për De Radën. Mblodhi dhe botoi këngë popullore arbëreshe në veprat "Dallëndyshja, Këngë dasme arbëreshe, të pabotuara" (La rondinella, Carme nuziale albanese, inedito, Foxha 1906); "Këngë popullore arbëreshe të kolonive të Italisë" (Canti popolari albanesi delle colonie d'Italia, Foxha, 1908); "Këngë arbëreshe të Kapitanatës dhe të Molizes" (Canti popolari albanesi della Capitanata e del Molise, Martina-Franka 1912). (Shpëtim Elezi)

MARKOVIQ Millovan (Milovan Marković) (1933-). Sociolog, profesor universiteti. Lindi në Pakashticë, komuna e Podujevës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa shkollën e mesme në Podujevë dhe Prizren. Degën e filozofisë dhe të sociologjisë e mbaroi në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Shkupit.

Një kohë punoi si mësimdhënës në gjimnazin e Prishtinës, ndërsa në vitin 1963 u zgjodh asistent në Fakultetin Juridik-Ekonomik. Studimet pasuniversitare i kreu në Beograd, kurse temën e doktoratës e mbrojti në Fakultetin Juridik të Universitetit të Shkupit në vitin 1973. Më vonë u zgjodh profesor i sociologjisë së përgjithshme në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës dhe po këtë titull e mbajti edhe në Fakultetin Juridik. Ishte edhe dekan i Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës. Pas demonstratave të vitit 1981, ishte aktiv në ndërmarrjen e masave diskriminuese, në diferencimin dhe ndëshkimin e studentëve dhe mësimdhënësve shqiptarë të Fakultetit Juridik. (Ismet Salihu)

MARKOVIQ Zhivojin (Živojin Marković) (1927-). Mjek, mjekoligjor, profesor universitar. Lindi në Ohër, shkollimin e kreu në vendlindje, ndërsa studimet i përfundoi në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Beogradit (1963). Po në këtë universitet e kreu edhe specializimin për mjekësi ligjore. Pas specializimit u emërua kryeshëf i Shërbimit Mjekoligjor në kuadër të Spitalit të Përgjithshëm të Prishtinës. Mbrojti tezën e doktoratës në Universitetin e Beogradit (1978). Ishte profesor ordinar i lëndës mjekësi ligjore. Publikoi një sërë punimesh shkencore dhe profesionale brenda dhe jashtë vendit. (Flamur Blakaj)

MARKOVIQ-PLAVNIK (Marković) Ismet (1948-). Poet boshnjak nga Kosova, kritik letrar, përkthyes. Lindi në Përnjavor të Plavës. Mbaroi studimet e filozofisë dhe sociologjisë së përgjithshme në Universitetin e Beogradit dhe të Prishtinës. Për 20 vjet ishte gazetar dhe redaktor i gazetës “Jedinstvo” në Prishtinë, në rubrikën e kulturës. Ishte edhe redaktor i revistës letrare “Stremljenja” në Prishtinë. Në periudhën 1992-2002 ishte në mërgim, në Zvicër dhe Itali. Botoi veprat me poezi: “Parakalimi” (1974), “Druri në shkronja” (1978), “Rabush” (1981), “I vuajturi” (1988). Nga gjuha shqipe në gjuhën serbokroate dhe boshnjake përktheu disa libra me poezi dhe publicistikë politike. Jeton në Pejë, Plavë dhe Ulqin. (Redaksia)

MARKU Mark (1927-2006). Aktor. Lindi në Bec të Gjakovës. Ishte i angazhuar në Teatrin e Kombësive në Shkup që nga themelimi i

tij. Luajti në një sërë rolësh në projekte të ndryshme teatrore dhe filmike, si në gjuhën shqipe, po ashtu edhe në atë maqedonase. Ndër shfaqjet më të rëndësishme ku aktrioi janë: “Rrenacaku”, “Mashtrimi”, “Moserati”, “Fundërrinat”, “Nita”, “Mbreti Edip”, “Hamleti nga Katranica e poshtme”, “Pahintikë në ëndërr” etj. U shqua në komeditë: “Martesa” e Gogolit, “Nikoletina Bursaç” e B. Qopiçit, “Mirandolina” e Goldonit etj. Realizoi role të shumta në radiodrama, kryesisht në Radio Prishtinën e dikurshme. Aktrioi në filmin “Era dhe Lisi” të B. Sataçiu dhe në projekte teatrore e filmike në gjuhën maqedonase. U shqua si aktor i komedisë. (Salajdin Salihu)

MARKU Zef Lush (1885-1920). Aktivist i lëvizjes kombëtare dhe mbështetës i ideve socialiste dhe komuniste. Lindi në Prizren, ku kreu edhe shkollën fillore. Gjendja e rëndë ekonomike e familjes e detyruan t'i ndërpriste mësimet dhe të shpërngulet në Shkup. Në monopolin e duhanit, ku u punësua, përhapi idetë e lëvizjes punëtore në mesin e rinisë së qytetit dhe të rrethinës dhe u bë njëri nga anëtarët më aktivë të organizatës socialiste të Shkupit. Më 1913 u punësua në Bankën Serbo-Franceze të Shkupit. Pas pushtimit të Shkupit nga Bullgaria (1915-1918), u mobilizua me detyrim në ushtrinë bullgare. Me t'u kthyer në Shkup, punoi në përhapjen e ideve të lëvizjes socialiste dhe komuniste në Kosovë e në Maqedoni gjatë viteve 1918-1920. Ishte anëtar i Sekretariatit Krahinor të Partisë Komuniste për Kosovën dhe Maqedoni. U përfshi në organizimin e fushatës parazgjedhore parlamentare, që u organizua nga komunistët në nëntor të vitit 1920. Gjatë kryerjes së kësaj detyre, u arrestua në periferi të Gjakovës nga xhandarmëria dhe u vra rrugës për në Prizren. Ishte komunisti i parë që u vra në Mbretërinë Serbe-Kroate-Slllovene. (Ramiz Abdyli)

MARTINI Gjergj Noc (1945-2012). Pikturor. Lindi në Shtoj të Ulqinit. Kreu Fakultetin e Arteve në Beograd më 1972. Një kohë punoi në gjimnazin e Ulqinit dhe më pas në Podgoricë, mësimdhënës i artit figurativ. Ishte anëtar i Shoqatës së Artistëve Figurativë të Malit të Zi dhe me këtë shoqatë hapi një sërë ekspozitash grupore, si: në Beograd, Novi-Sad, Rijekë, Prishtinë, Podgoricë, Ulqin, Tivar, Shkodër, Tiranë, Këln etj. Hapi edhe disa

ekspozita individuale në Dubrovnik, Herceg-Novi, Trebinje, Ulqin, Kotor, Podgoricë etj. Ishte laureat i disa çmimeve: çmimi i parë në Sallonin e Dhjetorit në Podgoricë, çmimi i Sekretariatit Republikan për Kulturë i Malit të Zi etj. (Rexhep Ferri)

MARTINOVIQ Mirash (Miraš Martinović) (1952-). Shkrimtar malazias nga Kosova. Lindi në fshatin Krale, pranë Andrijeviçës, në Mal të Zi. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Andrijeviçë, ndërsa studimet e letërsisë jugosllave në Fakultetin Filozofik në Prishtinë. Për shumë vjet ishte gazetar në gazetën “Jedinstvo” në Prishtinë, pastaj gazetar dhe redaktor në Radio Herceg Novi. Botoi përmbledhjet poetike: “Legjenda mbi qershinë” (1974) “Lutje buburrecit” (1985), “Rrathë në rërë” (1991) etj., si dhe romanet: “Heretiku” (1983), “Dita e fundit e Eskilit” (1995), “Mendimtarët e Babilonisë” (1998), “Hapja e Agruviumit” (2000), “Teuta” (2003), “Ëndrrat në Dokle” (2008), “Fjala e mbretërve” (2011), “Qytetet e lashta, ëndrra dhe fate” (2012) etj. Disa nga veprat e tij janë përkthyer edhe në gjuhë të tjera. (Ismet Markoviq)

MARRËDHËNIET KONTRAKTUALE TË KOSOVËS ME BE-në. Trajtim juridik i relacioneve Kosovë-Bashkim European (BE). Qëllimi i vendosjes së marrëdhënieve zyrtare kontraktuale midis Kosovës dhe BE-së është zyrtarizimi i këtyre raporteve, në mënyrë që procesi i integritit european të Kosovës të mos ngecë si pasojë e mungesës së unitetit brenda BE-së rreth statusit të Kosovës. Deri më tani nuk është gjetur një formulë, e cila do të pajtonte, në njërin anë, synimin e Kosovës dhe të pjesës dërrmuese të shteteve anëtare të BE-së për marrëdhënie kontraktuale dhe, në anën tjetër, të qëndrimit kategorik të pesë shteteve anëtare që hapat e përafrimit të Kosovës drejt BE-së të mos shihen si njohje e shtetësisë së Kosovës nga ana e këtyre shteteve. Hap i parë formal drejt marrëdhënieve kontraktuale konsiderohet fillimi i negociatave për Marrëveshjen për Stabilizim-Asocim (MSA) në vitin 2013. Ndonëse përfunduan me sukses negociatat për MSA-në, brenda BE-së kishte qëndrime të ndryshme për bazën ligjore, sipas së cilës do të mund të nënshkruhej marrëveshja e përmes së cilës do të vendoseshin marrëdhëniet kontraktuale të Kosovës me BE-në. Megjithatë,


zgjidhja u gjet te Traktati i Lisbonës i BE-së (2009), sipas të cilit Komisioni European mund të nënshkruajë marrëveshje ndërkombëtare në emër të BE-së pa pasur nevojë të marrë pëlqimin e Këshillit European. Prandaj, më 27 tetor 2015, në Strasburg kryeministri i Republikës së Kosovës, Isa Mustafa, nënshkroi MSA-në Kosovë-BE, me nënkryetaren e Komisionit European, Federika Mogerini, me çka Kosova, pas 15 vjetësh nga inaugurimi i procesit të stabilizim-asocimit u bë shteti i fundit që nënshkroi këtë marrëveshje, duke vendosur kështu marrëdhëniet kontraktuale zyrtare me BE-në. (Ilir Dugolli)

MARRËVESHJA “XHENTËLMENE” TITO-KYPRILI (1953). Marrëveshje e panënshkruar ndërmjet kryetarit të Jugosllavisë dhe ministrit të Jashtëm të Turqisë për shpërnguljen e shqiptarëve, turqve dhe boshnjakëve. Takimi Tito-Kyprili u mbajt në Split, më 10 prill 1953. Marrëveshja ishte vazhdimësi e Konventës së vitit 1938, e cila mbeti pa u ratifikuar nga Turqia, për shkak të luftës që tashmë shihej në horizont. Teksti integral i marrëveshjes “xhentëlmene” nuk është nënshkruar. Ajo i ka katër pika dhe në to nuk përmendet Konventa e vitit 1938, por lihet të kuptohet: bëhet fjalë për shpërnguljen e popullsisë të religjionit të njëjtë me turq, por nuk thuhet numri i emigrantëve, as koha e emigrimit, që do të thotë se limitet e saj do të mbesin çështje e posaçme e ministrive përkatëse; obligimet e dyanshme bëheshin me procedurën e “lëvizjes së lirë” të njerëzve në të dy drejtimet: shqiptarët në Turqi do të shkonin si “turq të natyralizuar”, me kërkesa të dokumentuara konsullore, si dhe hekurudhat jugosllave do të vihehin në dispozicion të dyanshëm. Drejtimi i parë i shpërnguljes ishte Prishtinë-Nish-Dimitrovgrad, ku kaluan 60% e të të shpërngulurve. Drejtimi i dytë ishte Shkup-Selanik-Edrene. Në sendërtimin e shpërnguljes ishin të përfshirë edhe Bullgaria, Greqia dhe Kisha Ortodokse Serbe, si dhe përfitues të tjerë. Pas disa ditësh nga nënshkrimi i marrëveshjes, në Shkup do të hapen mundësi që shqiptarët për një kohë të shkurtër të pajisen me pasaporta dhe shtetësi maqedonase. Emrat e të shpërngulurve deri më 1957 i ka publikuar pjesërisht gazeta “Nova Makedonija” dhe, sipas disa të dhënave, del se në periudhën 1951-1966 janë shpërngulur në Turqi rreth 450,000 shqiptarë, turq dhe boshnjakë. (Hakif Bajrami)

MARRËVESHJA E BRUKSELIT. Është marrëveshja e parë “e parimeve udhëheqëse për normalizim të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë”. Kjo marrëveshje ishte rezultat i dialogut politik ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, me ndërmjetësimin e Bashkimit European. U nënshkrua më 19 prill 2013 pas dhjetë raunde takimesh ndërmjet delegacionit të Kosovës të kryesuar nga kryeministri Hashim Thaçi dhe atij të Serbisë, të kryesuar nga kryeministri Ivica Daçiq. Marrëveshja ishte nënshkruar po ashtu edhe nga Përfaqësuesja e Lartë e BE-së për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Ketrin Ashton. Shumë shtete perëndimore e vlerësuan marrëveshjen si historike dhe një hap të rëndësishëm drejt normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve. Marrëveshja përmban 15 pika, përmes të cilave synohet eliminimi i strukturave paralele në veri të Kosovës, krijimi i mirëbesimit ndërmjet palëve dhe hapja e rrugës për marrëveshje të tjera ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Sipas marrëveshjes parashihet formimi i asociacionit të komunave me shumicë serbe në Kosovë, ku themelimi bëhet përmes statutit ndërsa shpërbërja mund të bëhet vetëm me vendim të komunave pjesëmarrëse. Marrëveshja parasheh gjithashtu integrimin e të gjitha strukturave policore në veri të Kosovës brenda Policisë së Kosovës dhe ndërprerjen e pagesave të dyfishta nga Serbia dhe Kosova, duke vendosur sistem unik të pagave nga ana e Policisë së Kosovës. Sipas marrëveshjes, pjesëtarët e strukturave të sigurisë në veri integrohen në strukturat përkatëse të Kosovës, ndërsa parashihet që komandanti rajonal i policisë për katër komunat me shumicë serbe në veri (Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq) të jetë serb i nominuar nga Ministria e Punëve të Brendshme. Edhe strukturat gjyqësore në veri të Kosovës duhet të përfshihen brenda kornizës ligjore të Kosovës dhe të themelohet një panel i përbërë me shumicë të serbëve të Kosovës, për të gjykuar të gjitha rastet e komunave me shumicë serbe. Marrëveshja obligon mbajtjen e zgjedhjeve lokale në veri të Kosovës, në përputhje me ligjet e Kosovës. Po ashtu parashihet që asnjëra palë (pra as Serbia, as Kosova) nuk do të bllokojë apo të inkurajojë të tjerët të bllokojnë progresin e palës tjetër në rrugën përkatëse drejt BE-së. Plani i zbatimit të marrëveshjes është pajtuar ndërmjet palëve më 23 maj 2013. Zbatimi i marrëveshjes mbikëqyret

nga një komision i veçantë, me përfaqësues të të dy palëve dhe me lehtësim të përfaqësuesve të BE-së, takimet e të cilit mbahen në Bruksel. Zbatimi i marrëveshjes është treguar i vështirë, i ngadaltë dhe është shoqëruar me kundërtënie e kritika të shumta. Aspekte të planit për zbatimin e marrëveshjes, si miratimi i ligjit për amnisti, kanë nxitur kritika të zëshme në Kosovë, përderisa rreth asociacionit të komunave serbe vazhdon të ketë perceptime të ndryshme për rolin dhe kompetencat e tij. (Ilir Dugolli)

MARRËVESHJA E RAMBUJESË (1999). “Marrëveshje e përkohshme për paqe dhe vetëqeverisje në Kosovë”, ishte titulli zyrtar i kësaj marrëveshjeje, që në të vërtetë ishte



FAKSIMILI I DOKUMENTIT TË MARRËVESHJES SË RAMBUJESË

një proces negociator Kosovë-Serbi, i ndërmjetësuar nga përfaqësuesit e Grupit të Kontaktit (SHBA, Britani e Madhe, Francë, Gjermani, Itali dhe Rusi). Ky proces filloi në kështjellën e Rambujesë (Francë) nga 6 deri më 23 shkurt 1999 dhe përfundoi në Paris nga 15 deri më 18 mars të vitit 1999. Nga aspekti i së drejtës ndërkombëtare publike nuk pati marrëveshje, sepse atë e nënshkroi në Paris vetëm njëra palë, ajo kosovare, kurse Serbia refuzoi nënshkrimin e saj. Nga aspekti i marrëdhënieve ndërkombëtare, ndërsa ky ishte një proces negociator i ndërmjetësuar ndërkombëtarisht i dy palëve ndërluftuese. Pra, një proces paqësor i papërfunduar me një traktat paqeje. Ideja e Grupit të Kontaktit,

sidomos pas masakrës së Reçakut (15 janar 1999), ishte që me këtë dokument të ndalej lufta në Kosovë dhe të rikthehej autonomia e abroguar e Kosovës brenda Serbisë dhe RFJ-së. Për shkak se në draftin final të dokumentit mungonte dispozita për organizimin e referendumit për statusin e ardhshëm të Kosovës, pala shqiptare kërkoi konsultime shtesë dhe u kthye në Kosovë. Pas dy javësh u rikthye në Paris, ku nënshkroi dokumentin, vetëm pas letrës interpretuese të ish-sekretares amerikane të shtetit Medelin Ollbrajt, se Marrëveshja, edhe pse nuk e përcaktonte shprehimisht, e nënkuptonte referendumin. Derisa në Rambuje zhvilloheshin negociatat, në Kosovë Serbia kishte 60,000 ushtarë, ndërkaq në periudhën dyjavore nga Rambujeja në Paris, dërgoi edhe 30,000 ushtarë të tjerë, si presion ndaj palës negociuese kosovare. Refuzimi i nënshkrimit nga ana e Serbisë vetëm sa e shpejtoi vendimin e NATO-s për të ndërhyrë ushtarakisht me bombardimin 78 ditësh të caqeve ushtarake serbe në Kosovë dhe në Serbi, si mënyrë e vetme për të siguruar paqen dhe për të mbrojtur popullsinë civile. Vetëm më 3 qershor 1999 Serbia pranoi planin 10 pikësh të Grupit të Kontaktit, i cili i referohej Marrëveshjes së Rambujesë, kurse Parlamenti i Serbisë po atë ditë e ratifikoi atë plan, me çka postfestum Serbia në një mënyrë e kishte pranuar Marrëveshjen e Rambujesë. (Blerim Reka)

MARRËVESHJA HOLLBRUK-MILLOSHEVIQ (13 tetor 1998). Marrëveshje ndërmjet emisarit amerikan për Ballkanin, Riçard Hollbruk (Richard Holbrooke) dhe Millosheviqit, e arritur në Beograd më 13 tetor 1998. Marrëveshja u arrit pas bisedimeve që zgjatën nëntë ditë. Marrëveshja ishte një pikë kthese për krizën në Kosovë, e cila erdhi më pas më 10 tetor 1998, kur Këshilli i NATO-s miratoi “Urdhrin për aktivizim”, i cili i lejonte komandantit suprem të NATO-s Uesli Klark të filonte sulmet ajrore brenda 96 orësh, në rast se konfirmohej se serbët nuk u bindeshin kërkesave të NATO-s. Ky presion ushtarak mbi Beogradin ishte vendimtar për ta detyruar Millosheviqin të bënte marrëveshje. Elementet kryesore të marrëveshjes ishin: përfundimi i veprimeve luftarake serbe në Kosovë, përbushja e dispozitave të Rezolutës 1199 të KS të OKB-së dhe zgjidhja paqësore e proble-

mit të Kosovës. Në anë tjetër, çdo zgjidhje për Kosovën duhet ta respektonte sovranitetin, integritetin territorial dhe njohjen e kufijve ndërkombëtarë të RSFJ-së, por edhe barazinë e të gjithë qytetarëve dhe bashkësive etnike. Millosheviqi u pajtua për një marrëveshje politike për një zgjidhje të përkohshme për shqiptarët e Kosovës, që do të përfshinte një vetëqeverisje të gjerë për Kosovën, polici lokale dhe zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, që do t'i mbikëqyrte OSBE-ja. Përveç kësaj, marrëveshja parashihte tërheqjen e trupave ushtarake dhe policore në pozicionet e tyre të para marsit të vitit 1998, hyrjen e lirë të organizatave ndërkombëtare në Kosovë, bashkëpunimin me Gjykatën Ndërkombëtare të Krimeve të Luftës për ish-Jugosllavinë, rikthimin e refugjatëve, fillimin e bisedimeve, mbikëqyrjen ajrore të NATO-s, amnistinë për të gjithë ata që ishin përfshirë në konflikt, me përjashtim të rasteve të krimeve kundër njerëzimit, si dhe hyrjen e misionit të verifikuesve të OSBE-së në Kosovë me 2,000 persona të paarmatosur. Pjesët e përfunduara të marrëveshjes u nënshkruan nga OSBE-ja, NATO-ja dhe pala serbe/jugosllave. Po ashtu, më 16 tetor u nënshkrua marrëveshja edhe ndërmjet Beogradit dhe OSBE-së në lidhje me Komisionin e Verifikimit. Marrëveshja shënoi ndërkombëtarizimin e plotë të krizës dhe futi përfaqësuesit ndërkombëtarë në tërë territorin e Kosovës. Por marrëveshja nuk dha zgjidhje përfundimtare për problemin e Kosovës. Sipas marrëveshjes, vëzhguesit e OSBE-së do të mbroheshin nga e ashtuquajtura “extraction force” e NATO-s, që ishte stacionuar në Maqedoni dhe që mund të bënte evakuimin eventual të tyre nga Kosova. Shef i Misionit Verifikues (MVK) të OSBE-së emëroi diplomatin amerikan Uilliam Uoker (William Walker). MVK-ja hapi zyrat e veta në Prishtinë, Gjilan, Pejë, Prizren dhe Gjakovë. Mirëpo Millosheviqi, edhe pse e kishte nënshkruar marrëveshjen, u përpoq ta shmange përbushjen e detyrimeve të marra. (Sylë Ukshini)

MARRËVESHJA KORNIZË E OHRIT (2001). Marrëveshja që ndërpreu luftën e vitit 2001 në Maqedoni midis Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare (UÇK) dhe shtetit të Maqedonisë. Kjo marrëveshje u arrit me ndërmjetësimin e SHBA-së dhe BE-së dhe me përkrahjen e NATO-s. Marrëveshja Kornizë e Ohrit, ose Marrëveshja e Ohrit, siç njihet gjerësisht,



NËNSHKRIMI I MARRËVESHJES SË OHRIT (2001)

ishte epilog i procesit negociator midis dy palëve: palës maqedonase (dy partitë politike të përfaqësuara në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë: VMRO-DPMNE-së dhe LSDM-së); dhe palës shqiptare (dy partitë politike në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë: PDSH-së dhe PPD-së). Marrëveshja u nënshkrua më 13 gusht të vitit 2001 në Shkup, por meqë i tërë procesi negociator ishte zhvilluar në Ohër, u quajt Marrëveshja Kornizë e Ohrit. Marrëveshja i dha fund luftës së vitit 2001, e cila nuk ishte luftë për territore, por për avancimin e statusit të shqiptarëve në Republikën e Maqedonisë, të cilët deri në vitin 2001 i kishin humbur edhe ato pak të drejta kolektive që i fituan me Kushtetutën e vitit 1974, me përfaqësimin në administratën shtetërore me vetëm 2%, ndonëse përbënin mbi 25% të popullsisë. Marrëveshja e Ohrit kishte tri qëllime kryesore: ndaljen e luftës dhe arritjen e paqes, ndryshimin e kushtetutës së Maqedonisë me avancimin e të drejtave kolektive të shqiptarëve dhe kthimin e besimit ndëretnik. Meqë qëllimi i parë u arrit vetvetiu me nënshkrimin e saj, dy qëllimet pasuese duhej të implementoheshin plotësisht deri në vitin 2004. Pjesë e konsiderueshme e qëllimit të dytë u realizua me ndryshimet kushtetuese në vitin 2001 dhe me nxjerrjen e ligjeve të reja në përputhje me këto ndryshime. Mirëpo, jo në të gjitha pikat e saj Marrëveshja u implementua, e veçmas viteve të fundit u vërejt ngecje e vazhdueshme. Edhe mbi 10 vjet pas afatit të përcaktuar për implementimin e plotë të Marrëveshjes (2004), tri çështje mbetën ende të pazbatuara: moszyrtarizimi i gjuhës shqipe, përfaqësimi joadekuat i shqiptarëve në administratën shtetërore dhe shpërndarja joadekuate e buxhetit shtetëror. Ndonëse amendamenti V i Kushtetutës së Maqedonisë

lejonte zyrtarizimin e përdorimit të gjuhës shqipe, kjo nuk u realizua. Nuk u arrit as përfaqësimi i shqiptarëve në administratën shtetërore të Maqedonisë, sepse përfaqësimi i përgjithshëm nuk shkoi më lart se 19.7%, ndërsa gjashtë prej funksioneve më të larta shtetërore në Maqedoni asnjëherë nuk u ushtruan nga ana e shqiptarëve. Ndërkaq, pabarazia e shpërndarjes së buxhetit shtetëror mbeti ende çështje e pazgjidhur. Ndonëse shqiptarët në Maqedoni plotësojnë buxhetin e shtetit me rreth 30% të të ardhurave, njësitë territoriale që kanë ata janë shumicë, nuk shfrytëzojnë më shumë se 5% të këtij buxheti. Vonesat dhjetëvjeçare në implementimin e kësaj marrëveshjeje janë theksuar edhe nga bashkësia ndërkombëtare, qoftë në raportet e progresit të BE-së, sikundër edhe në raportet vjetore të Departamentit Amerikan të Shtetit. Prandaj konsiderohet se Marrëveshja Kornizë e Ohrit mbeti dokument paqeje, që ndali luftën, por nuk zgjidhi shkaqet e kësaj lufte. (Blerim Reka)

MARRËVESHJA KOSOVË-SERBI E NDËRMJETËSUAR NGA BE-ja (“Fusnota”).

Marrëveshje e arritur gjatë procesit të dialogut teknik ndërmjet përfaqësuesve të Kosovës dhe të Serbisë, të lehtësuar nga Bashkimi Europian. Marrëveshja kishte për qëllim mundësimin e pjesëmarrjes së përfaqësuesve të Kosovës në takime të karakterit rajonal dhe anëtarësimin e Kosovës në organizata të karakterit rajonal. Sipas marrëveshjes së arritur më 24 shkurt 2012 ndërmjet delegacioneve të Kosovës dhe të Serbisë, Kosova në takime rajonale do të përfaqësohet me shënimin: “Kosovo*” (me fusnotë). Në fusnotë të jetë teksti si vijon: “Ky mbishkrim nuk e prejudikon statusin e Kosovës dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 të KS të OKB-së (1999) dhe Mendimin e GJND-së për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës”. (Iliir Dugolli).

MASAKRA E ABRISË SË EPËRME (26 shtator 1998). Masakër e forcave të policisë dhe të ushtrisë së Serbisë mbi popullsinë civile shqiptare në fshatin Abri e Epërme të komunës së Drenasit. Më 26 shtator 1998 popullsia civile e fshatit Abri e Epërme ishin strehuar nëpër malet e Drenicës, për t'i ikur ballafaqimit me forcat serbe. Disa nga këta banorë u strehuan në malin e quajtur Zabeli i Rrajave, që gjendet

ndërmjet fshatit Abri e Epërme dhe Likoc. Forcat serbe i sulmuan me bomba dore dhe më pas i vranë 24 civilë të fshatit Abri e Epërme të familjes Delija. Në këtë masakër e pësuan gra, pleq, fëmijë dhe banorë të pafuqishëm. Kjo masakër konsiderohet si njëra ndër masakrat më të rënda që bëri policia dhe ushtria e Serbisë mbi popullsinë civile në Kosovë, ngase nga familja Delijaj humbën jetën 24 anëtarë të moshës nga 1.5 vjeç, deri në moshën 94 vjeç. (Haxhi Ademi)

MASAKRA E BELEGUT (29-30 mars 1999).

Masakër e forcave ushtarake dhe policore të Serbisë e kryer në fshatin Beleg të komunës së Deçanit. Banorët e këtij fshati ishin kthyer në shtëpitë e tyre pas ofensivës së shtatorit të vitit 1998. Në fshatin Beleg ishin strehuar edhe banorë të fshatrave të tjera (Drenoc, Sllup, Irzniq, Hulaj, Carrabreg etj.), të cilët një ditë më parë ishin përzënë me dhunë nga shtëpitë e tyre. Më 29 mars fshati u rrethua nga të katër anët nga forcat serbe, të përcjellë me tanke, autoblanda dhe mjete të tjera të motorizuara. Njësitet e policisë serbe hynë nëpër shtëpi dhe i nxorën me dhunë banorët, duke i grumbulluar në qendër të fshatit. Me këtë rast i kishin ndarë burrat dhe gratë dhe, pas plaçkitjes dhe djegies së dokumenteve, burrat i mbyllën në një shtëpi dhe gratë e fëmijët në një shtëpi tjetër të fshatit, duke i mbajtur plot 24 orë nën tortura, përdhunime dhe keqtrajtime. Të nesërmen, më 30 mars, gratë dhe fëmijët i detyruan të nisen në drejtim të Shqipërisë, ndërkaq i ndaluan rreth 50 burra. Nga grupi i të ndaluarve nuk mbijetoi asnjë dëshmitar. Dëshmitarin e vetëm të mbijetuar nga ky grup, i cili me shumë plagë në trup kishte arritur të largohej nga vendi i ekzekutimit, policia serbe e kishte kapur pas tri javësh në fshatin Isniq të Deçanit, në një familje shqiptare, ku po mjekohej dhe e likuidoi për të zhdukur dëshmitë e krimeve. Pas përfundimit të luftës në një shtëpi të lagjes Vishaj të Belegut janë gjetur gjurmë të masakrës: eshtra gjymtyrësh të djegura, gishtërinj të duarve, unaza, pjesë të këmbëve, këpucë etj. Në vende të ndryshme janë gjetur mbetjet mortore të 12 të ekzekutuarve, ndërkaq edhe 34 civilë të tjerë vazhdojnë të konsiderohen të zhdukur. (Fetnete Ramosaj)

MASAKRA E BIHORIT. Aksion i bandave çetnike në krahinën e Bihorit, më 6 janar



CIVILË TË VARUR NË MASAKRËN E BIHORIT

1943, në të cilën u masakruan 3,741 burra, gra dhe fëmijë, u plagosën 634 persona, u grabit bagëtia dhe u dogjën disa fshatra. Krahina e Bihorit ishte zonë neutrale ndërmjet Malit të Zi dhe Shqipërisë të pushtuar nga Italia. Njësitë çetnike, që numëronin rreth 4,000 veta, pa asnjë shkas, me pëlqimin e komandës italiane, masakruan popullsinë shqiptare dhe boshnjake të Sanxhakut. Masakra e tronditi Kosovën dhe mbarë trojet shqiptare. Iliaz Agushi, ministër në qeverinë e Mustafa Krujës, formoi një komision për mbledhjen e të dhënave për këtë masakër. Komisioni, të cilin e drejtonte Emrush Miftari, me ndihmën e nënprefektit të Rozhajës, Demë Ali Pozharit dhe Bajram Gashit, mblodhi 4 arka me sy, koka e gjymtyrë njerëzish dhe gjinj të prerë të femrave. Këto arka u ekspozuan në Rozhajë dhe në Pejë dhe prej andej u dërguan në Tiranë, pranë organeve më të larta të pushtetit italian. Mirëpo qëndrimi mospërfillës i komandës italiane shkaktoi valë antiitaliane në Shqipëri e sidomos në Kosovë, reagim që u munduan ta shfrytëzonin komunistët për qëllimet e tyre politike. Mirëpo Partia Komuniste e Shqipërisë e heshti tërësisht masakrën dhe nuk e informoi asnjëherë opinion shqiptar për këtë ngjarje. (Muhamet Shatri)

MASAKRA E BURGUT TË DUBRAVËS

(maj 1999). Masakër e forcave policore dhe paramilitare të Serbisë mbi të burgosurit shqiptarë në Burgun e Dubravës, afër Istogut. Masakra ndodhi më 22 dhe 23 maj 1999, me ç'rast u ekzekutuan afro 170 të burgosur shqiptarë dhe u plagosën rreth 300 të tjerë. Fillimisht, në vitin 1998, me një vendim të Ministrisë së Drejtësisë së Serbisë, nga burgu i Dubravës u larguan të burgosurit politikë shqiptarë, të cilët



MASAKRA NË BURGUN E DUBRAVËS

u transferuan në burgjet në territorin e Serbisë, ndërsa burgju i Dubravës u shndërrua në kazermë të armatës serbe. Me fillimin e bombardimeve të NATO-s, Serbia sërish e mbushi burgun me të burgosur shqiptarë të transferuar nga burgjet e tjera të Kosovës, me civilë të kapur gjatë operacioneve luftarake, apo me të burgosur politikë, të cilët sërish u kthyen nga Serbia në Kosovë. Numri i të burgosurve kishte arritur rreth 950 veta, të cilët jetonin në kushte të rënda dhe keqtrajtoheshin vazhdimisht. Autoritetet ushtarake dhe policore serbe i kishin grumbulluar të burgosurit shqiptarë për t'i përdorur si mburojë njerëzore nga sulmet e NATO-s, e cila e kishte shënjuar burgun e Dubravës si cak të sulmeve të saj. Aeroplanët e NATO-s goditën burgun më 19 dhe 21 maj. Nga sulmi i dytë mbeten të vrarë rreth 20 të burgosur shqiptarë. Në këto rrethana, të burgosurit bënë përpjekje t'i dërgonin sinjal avionëve të NATO-s, duke shkruar në oborrin e burgut me materiale të ndryshme fjalën anglisht "Help!" (Ndihmë!), me shpresën se pilotët e NATO-s do ta identifikonin këtë sinjal. Por në mëngjesin e 22 majit 1999 autoritetet serbe të burgut vunë në veprim planin për ekzekutimin e të burgosurve shqiptarë. Së pari, u bë grumbullimi i gardianëve të burgut, pastaj armatosja edhe e të burgosurve serbë dhe, së fundi, rreshtimi i të burgosurve në oborrin e burgut, me pretekstin se do të transferoheshin në burgun e Nishit. Aty filluan të shtënat e armëve nga karakolli i pjesës perëndimorë të burgut dhe nga pjesët e tjera mbi murin e lartë të burgut. Ekzekutimi i shqiptarëve vazhdoi edhe më 23 maj, ku nga pozicione të ndryshme serbët e armatosur dhe të maskuar qëllonin pa ndërprerje. Sipas dëshmitarëve që mbijetuan këtë masakër, forcat serbe ekzekutuan rreth 170 të

burgosur shqiptarë dhe plagosën afro 300 të tjerë. (Enver Dugolli)

MASAKRA E CELINËS (25-28 mars 1999). Masakër e forcave ushtarake dhe policore të Serbisë mbi popullsinë civile të fshatit Celinë të komunës së Rahovecit. Më 25 mars të vitit 1999 forcat serbe të pajisura edhe me armatim të rëndë, të shoqëruara edhe nga serbë lokalë, pasi e rrethuan Celinën, i granatuan dhe i mitraluan shtëpitë e fshatit. Më pas forcat serbe hynë në fshat dhe brenda katër ditësh vranë dhe masakruan 82 civilë shqiptarë, kryesisht banorë të Celinës. Gjatë kësaj masacre u vranë dhe u masakruan 11 fëmijë të moshës nga 2-14 vjeç, 7 gra, 6 vajza të moshës madhore dhe 58 burra. Vrasja e civilëve u krye me armë zjarri dhe mjete të mprehta. Për t'i fshehur gjurmët e krimit, forcat serbe i dogjën me benzinë dhe kashtë disa nga këto viktime, disa të tjerë i larguan dhe i varrosen në Rahovec. Pas masakrës, forcat serbe plaçkitën dhe dogjën shumicën e shtëpive të fshatit dhe objektet ndihmëse, të gjitha objektet afariste e ekonomike, shkollën, xhaminë etj. Pasi vranë edhe 4 civilë, të mbijetuarit e masakrës u dëbuan me dhunë drejt Shqipërisë. Ndërkaq, trupat e pajetë të të masakruarve u varrosën në vendet ku ishin vrarë, nga bashkëfshatarët, të cilët kishin arritur t'i shpëtonin masakrës dhe të çanin rrethimin e forcave serbe. Pas luftës, gjatë muajit korrik të vitit 1999, viktimat e masakrës u zhvarrosën dhe, pas ekspertizës nga patologët ndërkombëtarë, u rivarrosën në Celinë. Gjatë këtyre zhvarrimeve, përkatësisht më 14 korrik 1999, në Celinë kishte qëndruar edhe Kryeprokurorja e Tribunalit të Hagës, Luiz Arbur. (Irir Ulaj)

MASAKRA E FUSHË-KOSOVËS (21prill 1999). Masakër e forcave të policisë dhe të ushtrisë së Serbisë mbi popullsinë civile shqiptare në fshatin Nakadër të komunës së Fushë-Kosovës. Në prill të vitit 1999 banorët e fshatit Nakadër kishin tentuar disa herë të largoheshin nga fshati, por ishin penguar nga forcat serbe. Më 21 prill 1999 u arrestuan 16 anëtar të familjes Mirena, që të gjithë meshkuj nga moshë 18 deri në 58 vjeç. Më pas, me përjashtim të një personi, të gjithë meshkujt e arrestuar të kësaj familjeje u ekzekutuan nga forcat serbe. Viktimat së pari u varrosën në fshatin Pomozotin të komunës së Fushë-

Kosovës, ndërsa dy ditë më vonë u zhvarrosën dhe i dërguan në drejtim të panjohur. Në vitin 2006 trupat e tyre janë gjetur në varrezën masive në Batajnicë të Serbisë. (Haxhi Ademi)

MASAKRA E GODENIT (25 mars 1999). Masakër e forcave të policisë dhe të ushtrisë së Serbisë mbi popullsinë civile shqiptare në fshatin Goden të komunës së Gjakovës. Masakra ndodhi më 25 mars 1999, një ditë pasi NATO-ja filloi bombardimet e caqeve ushtarake serbe. Fillimisht forcat serbe hynë nëpër shtëpi dhe nxorën jashtë banorët e fshatit, të cilët i grumbulluan në afërsi të shkollës fillore. Më pas ua dogjën shtëpitë dhe objektin shkollor. Nga grumbulli i civilëve, ushtarët dhe policët serbë veçuan 20 meshkuj, të cilët më pas i masakruan dhe i ekzekutuan në një shtëpi të djegur. Mbetjet mortore u varrosën në mes të fshatit, në një varr të përbashkët në shtator të vitit 1999. (Bedri Muhadri)

MASAKRA E HALLAQIT (1999). Masakër e ushtrisë dhe e policisë së Serbisë ndaj civilëve shqiptarë të fshatit Hallaq i Vogël i komunës së Lipjanit. Një ditë pas vrasjeve në Ribar të Vogël, më 19 prill 1999 ushtria dhe policia serbe vazhdoi reprezaljet edhe në Hallaq të Vogël. Me këtë rast u pushkatuan 20 shqiptarë. Dy nga ata i dogjën të gjallë, në një odë burrash të fshatit. Nga 40 meshkujt e grumbulluar, 13 i pushkatuan para syve të prindërve dhe fëmijëve të tyre, 2 prej të cilëve arritën të shpëtonin me plagë të rënda. Njërin nga banorët e fshatit, pas masakrimit, e dogjën. Një tjetrit, para pushkatimit, ia prenë dorën dhe ia nxorën njërin sy. Të plagosurit nga vendi i ekzekutimit u dërguan në fshatin Krojmir të Lipjanit, ku u mjekuan nga mjekët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. (Ali Uka)

MASAKRA E IZBICËS (28 mars 1999). Masakër e forcave të policisë dhe të ushtrisë së Serbisë mbi popullsinë civile në fshatin Izbicë të komunës së Skënderaj. Pas fillimit të bombardimeve të NATO-s, ushtria dhe policia e Serbisë më 25 mars 1999 filluan një ofensivë nga fshati Runik në drejtim të fshatit Klladërnice dhe Izbicë. Më 27 mars në fshatin Klladërnice, si hakmarrje për humbjet që kishin pësuar nga UÇK-ja, forcat serbe masakruan dhe vranë 67 civilë të moshave të ndryshme. Në të njëjtën ditë forcat serbe granatuan fshatin



MASAKRA E IZBICËS

Izbicë, ku ishin të strehuar rreth 8-10 mijë të zhvendosur të fshatrave përreth, kryesisht gra, fëmijë dhe pleq. Natën ndërmjet 27-28 marsit, rreth 4 mijë banorë e lëshuan fshatin dhe u nisën në drejtim të Tushilës. Të nesërmen forcat serbe rrethojnë vendin ku ishin të përqendruar popullsia civile, ndajnë meshkujt (mbi moshën 14-vjeçare) nga gratë, të cilat i nisën në drejtim të fshatit Vojnikë-Turiquec, duke i urdhëruar të vazhdojnë rrugën për në Shqipëri. Meshkujt e ndaluar i ndanë në dy grupe dhe prej 130 vetave sa ishin të renditur për ekzekutim, arritën të shpëtojnë vetëm 16 syresh, 12 prej të cilëve të plagosur. Kështu, në Izbicë u ekzekutuan gjithsej 114 persona. Masakra e dytë në fshatin Izbicë u bë më 11 maj 1999. Kjo masakër u krye në lagjen e Xhemajlajve, ku u vranë 12 banorë, kryesisht nga fshati Burojë. Viktimat u zhvarrosën më 28 maj nga policia serbe, për t'i humbur gjurmët e krimit, duke i rivarrosur në vende të ndryshme të Kosovës, ose në varrezën masive në Batajnicë të Serbisë. Në kompleksin memorial të fshatit Izbicë janë të shënuar emrat 147 personave të vvarë gjatë luftës së vitit 1998/99. (Haxhi Ademi)

MASAKRA E KOTLINËS (1999). Masakër e forcave ushtarake dhe policore të Serbisë ndaj popullsisë civile shqiptare, e kryer më 24 mars 1999 në fshatin Kotlinë të komunës së Kaçanikut. Sulmet e forcave serbe në këtë zonë filluan që nga 26 shkurti i vitit 1999. Më pas, më 9 mars fshati u sulmua nga forcat serbe, me çrast u dogj lagja Dreshec e këtij fshati. Në mbrojtje të fshatit kishin rënë dy dëshmorë, por popullsia civile kishte arritur të shpëtonte. Sulmin e forcave serbe e kishte konstatuar edhe ekipi i vëzhguesve të OSBE-së. Pas largimit të këtyre vëzhguesve, më 24 mars 1999 që në orët

e hershme të mëngjesit forcat serbe me artileri të rëndë, tanke, autoblanda dhe me mbi 7 mijë trupa këmbësorie e rrethuan nga të gjitha anët fshatin Kotlinë, i cili kishte mbetur fshati i vetëm i banuar me popullsi shqiptare. Nën granatimin e forcave serbe popullsia civile, rreth 350 gra, pleq e fëmijë, në panik ishin mbledhur në qendër të fshatit, të cilët pa vonuar u zunë rob nga forcat serbe. Në prani të tyre i torturuan rëndë e më pas u ekzekutuan tre pleq të fshatit. Një pjesë e banorëve të fshatit, kryesisht të rinj, ishin strehuar në malin mbi fshat. Disa orë më vonë forcat serbe i kishin zënë shumicën prej tyre. Për orë të tëra i torturuan mizorisht, duke i lidhur për drunj dhe duke i rrahur me shkopinj në të cilët kishin vendosur gozhda hekuri. Në orët e mbrëmjes, në vendin e quajtur "Shulla", rreth 400 metra në perëndim të fshatit Kotlinë, 22 të rinj ende të gjallë i hodhën në dy puse. Disa orë më vonë ushtria serbe i minoi pusët dhe i shkatërroi me eksploziv, për t'i zhdukur gjurmët e krimit. Trupat e pajetë të 22 banorëve të Kotlinës, shumica prej tyre të gjymtuar, u nxorën nga këto puse në shtator të vitit 1999. (Fetnete Ramosaj)

MASAKRA E KRUSHËS SË MADHE (25, 26, 27 mars 1999). Masakër e policisë dhe e ushtrisë së Serbisë ndaj popullsisë civile shqiptare në fshatin Krushë e Madhe të komunës së Rahovecit. Më 25 mars 1999 policia dhe njësitë e ushtrisë serbe filluan granatimin e fshatit Krushë e Madhe. Të nesërmen, më 26 mars, këto forca hynë në fshat, duke bastisur dhe djegur shtëpitë dhe duke ndarë burrat nga gratë dhe fëmijët. Meshkujt e veçuar u ndanë në tri grupe: grupin e parë e dërguan në Nagavc, grupin e dytë në xhaminë e Krushës së Madhe dhe grupin e tretë në një kodër jashtë fshatit. Pas rrahjeve dhe keqtrajtimeve të shumta, i ekzekutuan të gjithë dhe, më pas, kufomave të tyre ua vënë zjarrin, ndërsa shtëpinë në të cilën ishte vrarë njëri nga grupet e burrave, e shembën me eksploziv. Me qëllim të fshehjes së gjurmëve të krimit, një pjesë të viktimave u hodhën në lumë, jo shumë larg vendit të krimit. Sulmet, vrasjet dhe masakrimi i popullsisë civile shqiptare në Krushën e Madhe vazhdoi edhe më 27 dhe 28 mars të vitit 1999. Si pasojë e këtyre sulmeve në Krushë të Madhe gjetën vdekjen 243 persona, përfshirë edhe gra, fëmijë dhe pleq. Masakra e Krushës së Madhe është njëra ndër më të mëdhatë të kryera nga Serbia në Kosovë. (Teuta Shala-Peli)

MASAKRA E LIKOSHANIT DHE QIREZIT (28 shkurt 1998). Masakër e forcave të policisë dhe të ushtrisë së Serbisë ndaj civilëve shqiptarë në fshatin Likoshan dhe Qirez të komunës së Skënderajt. Masakra u bë më 28 shkurt 1998, pas humbjeve që forcat serbe pësuan gjatë përballjes me ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Forcat e UÇK-së lanë të vrarë shumë policë serbë dhe policia u detyrua të kërkonte përforcime, përfshirë edhe helikopterë. Në pamundësi për të thyer rezistencën e UÇK-së, forcat serbe filluan hakmarrjen ndaj banorëve të fshatrave Likoshan dhe Qirez, ku vranë dhe u masakruan 24 civilë. Në këtë masakër më së shumti pësuan familja Ahmeti nga Likoshani dhe familja Sejdiu nga Qirezi. (Haxhi Ademi)

MASAKRA E MANASTIRIT (1830). Masakër e ushtrisë osmane ndaj feudalëve shqiptarë, për të shuar lëvizjen shqiptare për vetëqeverisje. Menjëherë pas vrasjes së Ali Pashë Tepelenës, shumica e feudalëve të Shqipërisë së Jugut u hodhën në kryengritje, për të arritur vetëqeverisjen e vendit. Veçanërisht gjatë luftës ruso-turke (1828-1829) ata arritën t'ua hiqnin nga duart pushtetin funksionarëve osmanë. Në këtë gjendje të papërshtatshme për sundimin e saj në Shqipëri, pas paqes së Edrenesë, Porta e Lartë ngarkoi Mehmet Reshid Pashën që të merrte masa për t'i hequr kryengritjes udhëheqësit e saj më aktivë, Iljaz bej (Zylyftar) Podën, Asllan bej Pupën dhe Veli bej Jaçën. Sadriazemi i ftoi ata të vinin në Manastir, gjoja për të biseduar për çështje ushtarake dhe për pagesat e prapambetura të ushtarëve shqiptarë. Veli Beu dhe Asllan Beu me një varg bejlerësh të tjerë dhe me truprojat e tyre, gjithsej afër 1,500 veta, e pranuan ftesën. Zylyftar Poda, që e njihte urrejtjen e sadriazemit ndaj shqiptarëve dhe pabesinë e tij, nuk shkoi. Pritja u bë më 9 gusht 1830 në vendin e quajtur Dovlexhik, në të dalë të Manastirit, me një manifestim ushtarak, për t'u treguar atyre ushtrinë e re turke, të organizuar sipas shembullit evropian. Feudalët e ftuar u tradhtuan dhe u vranë në pabesi. Prijësve ua prenë kokat, të cilat i kripnin dhe i dërgonin në Stamboll. Masakra e Manastirit pati jehonë të madhe në Shqipëri dhe jashtë saj, dhe njëkohësisht i shtyu feudalët e tjerë të bashkohen me kryengritjen e Mehmet Pashë Bushatliut (1831). (Nebi Dervishi)

MASAKRA E MEJES (27 prill 1999). Masakër e forcave policore dhe ushtarake të Serbisë mbi civilët shqiptarë në jugperëndim të Gjakovës, në rajonin e Rekës së Keqe, pranë kufirit Kosovë-



VARRIMI I VIKTIMAVE TË MASAKRËS SË MEJËS

Shqipëri. Më 27 prillit 1999, forcat ushtarako-policore serbe ndërmorën një operacion të gjerë për spastrimin etnik të fshatrave të brezit kufitar me Shqipërinë, me ç'rast krahas djegieve, plaçkitjeve, shkatërrimeve e dëbimeve masive, vranë, masakruan dhe zhdukën të paktën 376 civilë shqiptarë. Operacioni i shifruar "Reka" u ndërmor nga ushtria e Jugosllavisë së mbetur dhe Ministria e Punëve të Brendshme e Serbisë, nga njësitet e policisë rajonale të Gjakovës, pjesëtarët e formacioneve paramilitare "Tigrat", "Beli Orlovi" dhe "Frenkistët", pastaj nga serbë vendas, vullnetarë rusë etj. Operacioni ishte i komanduar dhe i koordinuar nga ushtria serbe. Këto forca, pasi i vunë nën rrethim fshatrat Korenicë, Meje, Ramoc, Madanaj, Rrypaj, Rracaj, Dallashaj, Sheremet, Pacaj dhe Dobrosh, banorëve ua lënë të hapura dy rrugët që shpinin në drejtim të Mejës, ku e drejtuan gjithë popullsinë e kësaj ane, duke krijuar kolona të gjata më se 5 kilometra. Në Meje ishin ngritur dy pika kontrolli, në të cilat popullsia civile u nënshtua keqtrajtimit, torturave, plaçkitjeve, përdhunimeve, djegies së dokumenteve të identifikimit etj. Civilët nga andej dëboheshin në drejtim të Gjakovës dhe më pastaj në drejtim të Shqipërisë. Përderisa një numër i civilëve shqiptarë u vranë në fillim të operacionit nëpër shtëpitë e tyre, madje edhe u dogjën të gjallë, vetëm në dy pikat e kontrollit në Meje forcat serbe paraburgosën 348 meshkuj të moshës 14 deri 86 vjeç, si dhe 3 femra, për fatin e të cilëve për më shumë se katër vjet nuk është ditur asgjë. Nga e gjithë

zona, më së rëndi e pësoi fshati Korenicë, ku u ekzekutuan 70 banorë, si dhe 32 të zhvendosur nga fshatrat e tjera. Pas përfundimit të luftës, mbetjet mortore të 309 shqiptarëve të ndaluar në Meje u gjetën në varrezat masive në periferi të Beogradit. Asnjë nga të ndaluarit nuk është liruar dhe nuk ka mbijetuar, kështu që nuk ka dëshmitarë të gjallë të kësaj masakre. Masakra e Mejës është vrasja më e madhe masive që ndodhi gjatë luftës së vitit 1999 në Kosovë. (Fetnete Ramosaj)

MASAKRA E PADALISHTËS (26 mars 1999). Masakër e forcave të policisë dhe të ushtrisë së Serbisë mbi popullsinë civile shqiptare në fshatin Padalishtë të komunës së Istogut. Në mëngjesin e hershëm të 26 marsit 1999, forca të shumta policore dhe ushtarake serbe rrethuan fshatin Padalishtë. Për t'iu shmangur dhunës dhe vrasjes, shumë fshatarë i braktisën shtëpitë e tyre dhe u larguan në kërkim të vendeve më të sigurta. Anëtarët e familjes Imeraj u vendosën në fund të fshatit. Pas keqtrajtimit të shumta, u masakruan dhe u vranë 19 anëtarë të familjes Imeraj. Të masakruarit ishin nga moshja 2-76 vjeç. Nga 19 personat e masakruar të kësaj familjeje, 11 ishin femra dhe 5 fëmijë të moshës 2-16 vjeç. (Haxhi Ademi)

MASAKRA E PASTASELIT (31 mars 1999). Masakër e forcave policore dhe ushtarake të Serbisë mbi popullsinë civile shqiptare në fshatin Pastasel të komunës së Rahovecit. Në këtë masakër u vranë 106 civilë shqiptarë prej moshës 14-95 vjeç. Fshati Pastasel shtrihet në pjesën jugperëndimore të malit Koznik, rreth 10 km në veriperëndim të Rahovecit. Në ditët e fundit të muajit mars të vitit 1999, në fshatin Pastasel ishin zhvendosur mijëra banorë shqiptarë të dëbuar nga komuna e Rahovecit, Klinës, Malishevës, Skënderajt, Pejës etj. Ditën e masakrës forcat e ushtrisë dhe të policisë serbe e granatuan fshatin me artileri të rëndë nga të gjitha anët. Për t'iu shpëtuar predhave, banorët u detyruan t'ia mësyjnë luginës që gjendej menjëherë nën fshat. Ndërkohë, forcat serbe me tanke depërtuan në fshat, i rrethuan civilët, ua plaçkitin grave stolitë dhe gjërat e vlefshme dhe i urdhëruan të nisen në drejtim të Shqipërisë. Nga turma i ndanë 120 meshkuj. Pasi ua konfiskuan letërnjoftimet, me të rënë muzgu të ndaluarit i dërguan buzë përroit, ku

i ekzekutuan me rafalë automatikësh. Një ditë më vonë, për t'i zhdukur gjurmët e krimin, një numër kufomash i dogjën në rimorkio të traktorëve dhe në shtëpitë që gjendeshin aty pranë. Kufomat tjera i lanë në fund të rrëpirës pranë përroit. Dy ditë pas masakrës, banorë lokalë të mbijetuar i varrosën të ekzekutuarit pranë shkollës së fshatit. Pas bërjes publike të masacrës, më 21 prill 1999 policia serbe i zhvarrosi trupat e të vrarëve dhe me një kamion civil i barti në drejtim të Rahovecit, me qëllim të zhdukjes së gjurmëve. Fati i dhjetë personave të zhvarrosur edhe sot mbetet i paditur. Nga 106 të ekzekutuar, shumica ishin nga fshatrat e komunës së Rahovecit: Pastaselit, Senocit, Zatriqit, Kramovikut, Polluzhës, Çifllakut, Kaznikut e Gurit të Kuq, ndërsa të tjerët nga Gremniku i Klinës, Malisheva, Peja, Skënderaj etj. Masakrës i mbijetuan 14 dëshmitarë, dy prej të cilëve dëshmuar edhe në Tribunalin e Hagës. (Fetnete Ramosaj)

MASAKRA E PAVLANIT (14 prill 1999). Masakër e forcave të policisë dhe të ushtrisë së Serbisë mbi popullsinë civile shqiptare në fshatin Pavlan të komunës së Pejës. Çak i sulmeve të forcave ushtarake-policore serbe, përveç fshatit Qyshk, ishte edhe fshati Pavlan. Menjëherë pas vrasjes dhe masakrimit të fshatarëve të fshatit Qyshk, forcat serbe e vazhduan aksionin në drejtim të fshatit Pavlan, duke përdorur të njëjtën metodë të dhunës dhe të kimit. Forcat serbe hynë në fshat, por për t'iu shmangur dhunës dhe vrasjeve, një numër banorësh tashmë i kishin braktisur shtëpitë, duke kërkuar strehim më të sigurt. Gjatë këtij operacioni të forcave të Serbisë në fshatin Pavlan më 14 maj 1999 u vranë dhe u masakruan 10 persona, në mesin e të cilëve edhe dy femra. (Teuta Shala-Peli)

MASAKRA E QYSHKUT (14 maj 1999). Masakër e policisë dhe e ushtrisë së Serbisë ndaj civilëve shqiptarë në fshatin Qyshk të komunës së Pejës. Në mëngjesin e 14 majit të vitit 1999, forca të shumta të policisë dhe të ushtrisë së Serbisë rrethuan fshatin Qyshk dhe hynë shtëpi më shtëpi, duke i detyruar banorët që t'i braktisnin ato. Më pas urdhëruan ndarjen e burrave nga gratë dhe fëmijët. Pas plaçkitjes, i ndanë nga turma 32 burra, ndërsa pjesën tjetër të banorëve i detyruan të niseshin në drejtim të qytetit të Pejës. Këta 32 burrat, të ndarë në tre grupe, i vendosin në tri dhoma, në tri

shtëpi të ndryshme. Posa i futnin brenda, mbi ta zbraznin breshëri plumbash dhe, në fund, kufomave ua vënë zjarrin. Në grupin e parë ishin 12 veta, në grupin e dytë dhe të tretë nga 10 veta. Po me këtë rast, forcat serbe në fshatin Qyshk vranë edhe disa persona të tjerë, kështu që numri i përgjithshëm i të vrarëve ishte 41 veta. Të njëjtën ditë masakra të njëjta u kryen edhe në fshatrat Pavlan dhe Zahaq, kështu që numri i përgjithshëm i të vrarëve në këto tre fshatra arrinte në 73 veta. (Teuta Shala-Peli)

MASAKRA E RANCËS (26 gusht 1998). Masakër e forcave ushtarake dhe policore të Serbisë mbi popullsinë civile, e zhvilluar më 26 gusht 1998 në Livadhin e Gjatë të fshatit Greiçevc të komunës së Suharekës. Forcat serbe gjatë granatimit në distancë mbi popullsinë civile të këtyre vendbanimeve, e cila ishte strehuar në rripin malor i quajtur Livadhi i Gjatë, në mes fshatit Topillë dhe Greiçevc, vranë gjatë lëvizjes në kolonë familjen 11 anëtarëshe Asllani. Forcat serbe qëlluan me granatë topi mbi rimorkionin e traktorit të kësaj familjeje, me ç'rast u vranë 11 anëtarët e familjes Asllani, prej të cilëve 8 fëmijë nga moshën 6-muajshe e deri në 13 vjet, ndërsa të plagosur mbeten edhe tre persona të tjerë, të cilët gjithashtu ndodheshin në traktor. Ushtria serbe, në të njëjtën ditë, në fshatin Rancë ekzekutoi edhe një person të moshuar. Mediet kryesore botërore njoftuan për këtë krim, bashkë me imazhet tronditëse të masakrës. (Ruzhdi Jashari)

MASAKRA E REÇAKUT (15-17 janar 1999). Njëra nga masakrat më të madha të ushtrisë dhe policisë së Serbisë në Kosovë. Në mëngjesin e hershëm të 15 janarit të vitit 1999 forcat serbe sulmuan fshatin Reçak. Me forcat e ushtrisë dhe të policisë ishin bashkuar edhe civilë serbë të Shtimes, të Ferizajt dhe të Vitisë. Në fshat, përveç banorëve të përhershëm, ndodheshin edhe të strehuarit e fshatrave përreth. Policët dhe paramilitarët ishin futur me forcë nëpër shtëpitë e fshatit, i kishin nxjerrë jashtë banorët dhe disa syresh i kishin ekzekutuar nëpër oborret e shtëpive, në prezencë të familjarëve. Ndërkaq, një numër i fshatarëve ishin ekzekutuar në Kodrën e Bebushit, mbi fshatin Reçak. Në mesin e të ekzekutuarve kishte me pjesë të hequra të trupit: sytë, koka, zemra etj. Gjithsej të ekzekutuar ishin 42 persona. Numri i përgjithshëm i të plagosurve ishte



MASAKRA E REÇAKUT

26 veta, nga të dy gjinitë. Meqë ishte në fuqi marrëveshja e tetorit për armëpushim dhe në Kosovë vepronte misioni monitorues i OSBE-së, skenat e këtij krimi u vizituan nga shefi i këtij misioni, ambasadori Uilliam Uoker. Ngjarja u transmetua për opinionin botëror nga mediet e shumta. Deklarata e ambasadori Uoker saktëson se bëhej fjalë për një masakër dhe për një ekzekutim të civilëve të pambrojtur, prandaj ngjarja u cilësua si krim kundër njerëzimit. Në mëngjesin e 17 janarit pushteti serb kishte nisur drejt Shtimes prokuroren e Prishtinës, në shoqërim të eprorëve policorë, për t'i marrë kufomat e masakrës për obduksion në Qendrën Spitalore në Prishtinë. Ishte e qartë se Beogradi synonte t'i manipulonte provat e masakrës. Ndërkaq, pala shqiptare kishte kërkuar që obduksioni të bëhej nga patologët shqiptarë dhe ndërkombëtarë. Me këto kërkesa nuk u pajtua pala serbe, e cila si përgjigje nisi drejt Reçakut forca të shumta të policisë dhe të ushtrisë për marrjen e kufomave. Në këto rrethana, rreth orës 9.00 të 17 janarit 1999 nisën luftimet e rrepta për kufomat, ndërmjet forcave serbe dhe UÇK-së. Luftimet u zgjeruan përgjatë gjithë vijës së frontit dhe zgjatën deri më 20 janar 1999. Në këto luftime pati të vrarë nga të dyja palët. Ndërkohë, kufomat e masakrës u tërhoqën nga forcat serbe nga fshati dhe u dërguan në Prishtinë. Deri më 10 shkurt 1999 regjimi serb bëri përpjekje të pasuksesshme për manipulimin e fakteve të masakrës së Reçakut. (Syle Ukshini, Ruzhdi Jashari)

MASAKRA E REZALLËS (5 prill 1999). Masakër e forcave të policisë dhe të ushtrisë së Serbisë mbi popullsinë civile shqiptare në fshatin Rezallë të Skënderajit. Më 5 prill 1999

forcat serbe hynë në fshatin Rezallë dhe, duke shtënë me breshëri armësh, i detyruan banorët të tubohen në qendër të fshatit. Më pas banorët e tubuar i dërguan në një shtëpi të fshatit, ku ua plaçkitën paratë, gjësendet me vlerë dhe dokumentet personale. Me atë rast i ndajnë me një anë meshkujt dhe më pas shtinë mbi 41 civilë të moshës nga 13-90 vjeç. Nga kjo masakër shpëtuan vetëm tre persona, gjithsej u vranë 38 persona, 29 prej të cilëve ishin nga fshati Rezallë, 7 nga fshati Morinë dhe dy nga fshatrat Llazicë dhe Prekaz. Një ditë më pas forcat serbe i varrosën të vrarët me ekskavator, ndërsa më 16 maj i zhvarrosën viktimat dhe i dërguan në drejtim të panjohur, ndërsa në vendin ku kishin qenë të varrosur viktimat e kësaj masakre, kishin hedhur kafshë të ngordhura për t'i humbur gjurmët e krimit. Gjatë luftës së fundit në Kosovë (1998-1999) në këtë fshat janë të vrarë gjithsej 80 banorë të moshës nga 5 vjeç deri në 90 vjeç. (Haxhi Ademi)

MASAKRA E RIBARIT (1999). Masakër e ushtrisë dhe e policisë së Serbisë ndaj civilëve shqiptarë të fshatit Ribar të komunës së Lipjanit. Në orët e mëngjesit të 18 prillit 1999 ushtria dhe policia serbe, e ndihmuar nga serbët lokalë, hynë në fshatin Ribar të Vogël, ku pa asnjë shkas masakruan 25 banorë shqiptarë të moshës 7-90 vjeç. Pas nxjerrjes me dhunë nga shtëpitë e tyre, i qëlluan nga prapa me automatikë. Nga të vrarët, 19 ishin banorë të Ribarit të Vogël, ndërsa 6 të tjerë ishin anëtarë të familjes Vuniqi nga fshati Vërshhec, të cilët që nga ofensiva e parë, korrik-tetor 1998, ishin strehuar në këtë fshat. Pas vrasjeve dhe dëbimit të banorëve, filluan plaçkitjet, shkatërrimi i shtëpive dhe djegia e tyre. (Ali Ukaj)

MASAKRA E ROGOVËS (27-29 janar 1999). Vrasja brenda 3 ditëve e 21 ushtarëve dhe eprorëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) dhe e 9 civilëve. Pas ofensivës njëmuajore të forcave serbe (17 dhjetor 1998-17 janar 1999) në Zonën Operative të Dukagjinit u paraqit nevoja për furnizim me armë të UÇK-së dhe transferim të të plagosurve në Shqipëri. Një grup i përbërë prej 96 vetash, pjesëtarë të UÇK-së të Zonës Operative të Dukagjinit dhe një njësit i Zonës Operative të Pashtrikut më 27 janar 1999 u nisën nga Zhebeli në drejtim të Shqipërisë. Tek Ura e Terzive, afër fshatit

Bishtazhin të Gjakovës, rreth orës 23 ata ranë në pritë të forcave serbe. Gjatë përlëshjes u vranë dy pjesëtarë të UÇK-së dhe u plagosën dy të tjerë. Një pjesë e këtij grupi u kthye për në Jabllanicë, ndërsa 25 luftëtarë të tjerë vazhduan rrugën drejt Shqipërisë, në drejtim të Godenit. Mbi fshatin Goden, në afërsi të kufirit Kosovë-Shqipëri grupi ra në pritë të forcave serbe dhe në përlëshje e sipër u vranë 2 ushtarë të UÇK-së, ndërsa u plagosën 5 të tjerë. Pas kësaj prite, grupi sërish u kthye në fshatin Goden dhe prej andej arritën në fshatin Rogovë të Hasit, ku zunë strehë në një shtëpi të këtij fshati. Të nesërmen rreth orës 5:30 të mëngjesit të 29 janarit, gjatë udhëtimit me një furgon, vërejnë pritën tjetër të forcave serbe dhe u kthyen sërish në fshat. Por disa minuta më pas arritën forcat serbe dhe menjëherë filluan të qëllojnë në drejtim të furgonit, ku gjendeshin 18 pjesëtarë të UÇK-së dhe shoferi i makinës. Nga të gjithë sa ishin në mjetin transportues, arritën të shpëtojnë vetëm dy ushtarë. Po atë ditë në Rogovë të Hasit u ekzekutuan edhe nëntë civilë të fshatit. Te shumica e të vrarëve u vërejtën shenja të qarta të ekzekutimit dhe masakrimit të kufomave. (Fetnete Ramosaj)

MASAKRA E SKËNDERAJT (20 mars 1999).

Masakër e forcave të policisë dhe të ushtrisë së Serbisë ndaj popullsisë civile shqiptare në qytetin e Skënderajt. Gjatë vitit 1999 në Skënderaj janë bërë dy masakra të mëdha. Masakra e parë u bë më 20 mars 1999, ku janë vrarë 29 persona civilë të moshës 15 deri 70 vjeç. Masakra e dytë u bë më 16 prill 1999, kur në këtë qytet u vranë nga forcat serbe 16 persona të Skënderajt dhe të fshatrave përreth. Të gjitha viktimat u vranë nëpër shtëpitë dhe oborret e tyre, shumica në prani të familjarëve. (Haxhi Ademi)

MASAKRA E SLLOVISË (15-16 prill 1999).

Masakër e forcave ushtarake dhe policore të Serbisë ndaj popullsisë civile të fshatit Sllovijë të Lipjanit, në të cilën u vranë 45 civilë shqiptarë dhe dhjetëra të tjerë u plagosën. Fshati Sllovi gjatë bombardimeve të NATO-s ishte kthyer në bazë të formacioneve ushtarake, policore dhe paramilitare serbe. Më 15 prill 1999 forcat serbe me 5-6 tanke ishin pozicionuar në një kodër mbi fshat, të cilat në mëngjes filluan sulmin mbi fshatin Akllap. Me këtë rast u dogj fshati dhe u vra një i moshuar. Më pas nisi sulmi mbi fshatin

Sllovi nga dy drejtime, nga krahu i Akllapit dhe i Gushtericës së Epërme. Forcat serbe, të përqendruara më herët në familjet serbe, kishin zënë të gjitha udhëkryqet dhe hyrjedaljet e fshatit. Me këtë rast u vranë 24 civilë. Një ditë më vonë, më 16 prill, ushtria serbe te Lugu i Demës, po në këtë fshat, i masakroi edhe 17 civilë shqiptarë (16 burra dhe një grua) të moshave të ndryshme. Ekzekutimet e prindërve u kryen në prezencë të fëmijëve dhe mbytyet barbare të fëmijëve u bënë në prezencë të prindërve me armë zjarri dhe me therje dhe prerje gjymtyrësh me bajoneta e thika dhe me goditje me dru. Autopsitë e kufomave të të vrarëve u kryen nga hetuesit e Tribunalit të Hagës. (Ruzhdi Jashari, Ali Uka)

MASAKRA E STUDIMES (2 maj 1999).

Masakër e kryer nga forcat ushtarake dhe policore të Serbisë ndaj popullatës civile shqiptare në Studime, Vushtrri, në të cilën u vranë 99 civilë shqiptarë. U bë në shenjë hakmarrjeje për humbjet që pësonin ushtria dhe policia e Serbisë nga UÇK-ja dhe bombardimet e NATO-s. Shumica e civilëve u ekzekutuan nga afër, me nga një plumb në kokë. Në ekzekutimin e civilëve kanë marrë pjesë policë serbë vendorë nga Vushtrria dhe zonat e tjera përreth. Me qëllim të përkujtimit të kësaj masakre, në varrezat ku janë varrosur të vrarët shqiptarë në Studime është ngritur një përmendore me emrat e të vrarëve, ku janë skalitur emrat e 116 të rënëve. (Izet Miftari)

MASAKRA E SUHAREKËS (26 mars 1999).

Masakër e ushtrisë dhe policisë së Serbisë ndaj civilëve shqiptarë të Suharekës, me çrast u vranë 57 anëtarë të familjes së gjerë Berisha. Rreth mesditës së 26 marsit 1999 ushtarë dhe policë serbë rrethuan shtëpitë e Berishajve. Më pas i nxorën jashtë të gjithë dhe i ndanë burrat nga gratë dhe fëmijët. Grave dhe fëmijëve u thanë që të ikin, ndërsa shtatë meshkuj i pushkatuan para shtëpisë së tyre. Më pas, afër stacionit të autobusëve në Suharekë ua zënë rrugën grave edhe fëmijëve dhe me dhunë i fusin në kafenenë "Kalabria". Pasi i urdhëruan të ulen, hapin zjarr mbi ta nga automatikët për afro 30 minuta. Pak më vonë qëlluan për herë të dytë dhe hodhën disa bomba dore. Vranë me këtë rast nga foshnja 10 muajsh e deri te gruaja 65 vjeçe. Për t'i humbur gjurmët e krimit, trupat e të vrarëve i ngarkuan në një kamion të

mbuluar. Në rrugë e sipër vrasin edhe ndonjë të plagosur. Masakrës i shpëtuan tre persona, dy gra dhe një fëmijë (Shyhretja, Vjollca dhe Gramosi 8 vjeç). Kur kamioni arriti afër fshatit Malësi e Re, Shyhretja, Vjollca dhe Gramosi kërcyen nga kamioni. Shyhretes i japin ndihmë disa vendës, të cilët e dërguan në një bazë të UÇK-së. Vjollca me Gramosin u strehuan në fshatin Caparc të Prizrenit. Kufomat e familjes Berisha i varrosin në poligonin e kazermës në Prizren dhe pas dy javësh i dërguan në Batajnicë afër Beogradit. (Ali Uka, Ruzhdi Jashari)

MASAKRA E TIVARIT. Vrasje masive e të mobilizuarve nga Kosova, që ndodhi në Tivar, më 1 prill 1945. Në fillim të vitit 1945, në Kosovë filloi mobilizim i përgjithshëm për plotësimin



REKRUTËT KOSOVARË PARA MASAKRËS SË TIVARIT

e efektiveve të Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Jugosllavisë (UNÇJ). Më 20 mars 1945, Shtabi Suprem i UNÇJ-së urdhëroi Shtabin Operativ të Kosovës që të niste të mobilizuarit drejt bregdetit Adriatik dhe veriperëndimit, për plotësimin e reparteve të Armatës IV të Jugosllavisë. Marshuta ishte Prizren-Kukës-Pukë-Shkodër-Tivar-Dubrovnik-Rjekë. Grupi i parë i të mobilizuarve nga Ferizaj (2,200 veta) dhe nga Prizreni (1,500 veta) u shoqërua rrugës nga një batalion i Divizionit të 46-të serb dhe batalioni me 50 oficerë të Armatës IV të Jugosllavisë. Grupin e dytë e përbënin të mobilizuarit nga qarqet e Pejës (900 veta), të Mitrovicës (1,100 veta) dhe të Prishtinës (1,500 veta), të cilët gjithashtu përcilleshin nga repartet e Divizionit të 46-të. Pas grumbullimit të të gjithë të mobilizuarve në Prizren, Shtabi Operativ i Kosovës i ndau në tri grupe me nga 2,500 veta. Nga të tri kolonat e pësoi më

së shumti kolona e dytë, e përbërë nga 2,382 veta. Ajo u nis nga Prizreni më 26 mars dhe iu dorëzua më 30 mars në Shkodër reparteve të Brigadës X Malazeze. Për shoqërimin e tyre u ngarkuan repartet e Brigadës XXVII serbe. Sjellja ndaj tyre nuk ishte e mirë as nga autoritetet e Shqipërisë. Gjatë marshimit, 8 veta që u sëmurën nga tifoja mbetën në spitalin e Fushë-Arrëzitet, 3 u orvatën të iknin, por u zunë, kurse njëri bëri vetëvrasje, duke kërcyer nga ura.

Për vrasjet masive që ndodhën në Tivar, si pretekst shërbeu një konflikt te një krua, afër Monopolit të Duhanit në Tivarin e Ri, midis një shqiptari të mobilizuar dhe rojës. Kur arritën të mobilizuarit te Monopoli i Duhanit, pasuan breshëri të shtënash mbi shqiptarët nga të gjitha anët. Brenda një kohe të shkurtër nga grumbulli i njerëzve në oborr, në shesh dhe në ndërtesë asnjë nuk mbeti në këmbë. Në rrugën para ndërtesës së Monopolit me gjerësi 6-7 metra me një gjatësi prej 60 metrash mbetën rreth 400 kufoma. Më pas, gjatë pastrimit të vendit, në mjetet e transportit u ngarkuan bashkërisht të vranët dhe të plagosurit dhe u hodhën në det. Pas kërkesave këmbëngulëse të atyre që shpëtuan, u bë verifikimi i të gjallëve. U konstatua se ata ishin 810 veta. Një pjesë e mirë e të plagosurve mund të shpëtonin, në rast se do t'u jepej ndihmë mjekësore. Por edhe peripecitë dhe vuajtjet e të gjallëve nuk mbaruan me kaq. Shpëtuan vetëm disa nga ata që patën fatin të strehohen në oborret dhe familjet e shqiptarëve në Tivar dhe rrethinë.

Për numrin e të vranëve në Tivar janë dhënë shifra të ndryshme. Në raportet e Komandës së Qarkut të Shkodrës theksohet se nga grupi i dytë me më se 3,000 të mobilizuar u vranë 500 veta. Ndërkaq shtabit i Divizionit të 46-të të Serbisë pranon 550 veta të nxjerrë nga radhët, prej të cilëve 350 të vranë e 150 të plagosur. Të dhënat zyrtare vërtetojnë se në organizimin e masakrës morën pjesë edhe komandanti e komisari i Brigadës X, si dhe gati të gjitha organet ushtarake dhe civile që u gjendën në Tivarin e Ri, madje edhe personeli mjekësor. Masakrën e shqiptarëve në Tivar e pranon edhe Aleksandar Rankoviç, i cili në Kongresin I të Partisë Komuniste të Serbisë (maj 1945) e pranon se u vranë 430 shqiptarë. Ai u përpoq ta paraqiste këtë masakër si rrjedhojë e gabimeve të organeve të niveleve të ulëta gjatë zbatimit në praktikë të vijës së Partisë Komuniste të Jugosllavisë.

Bashkëfajtorë për masakrën ishin edhe autoritetet e Shqipërisë. Dëshmitarët nga ajo ngjarje bëjnë të ditur se të mobilizuarit kosovarë vriteshin në masë gjatë rrugës nëpër Shqipëri. Ata që iknin nga kolonat për të shpëtuar koken dhe dorëzoheshin tek organet shqiptare, i ktheheshin komandës jugosllave, e cila pastaj i dënonte me vdekje. (Muhamet Shatri)

MASAKRA E VUSHTRRIË (22 maj 1999). Masakër e kryer nga forcat ushtarake dhe policore të Serbisë ndaj popullatës civile shqiptare në Vushtri, në të cilën janë vrarë mbi 60 veta. Më 22 maj 1999 forcat serbe larguan me forcë qytetarët nga shtëpitë e tyre dhe i detyruan të grumbulloheshin te vendi i njohur “Te vorret” në qytetin e Vushtrrisë. Një numër i të dëbuarve u dërguan në Smrekonicë dhe disa të tjerë për në Shqipëri. Të masakruarit kanë qenë burra dhe gra të moshave të ndryshme. Pas ekzekutimit, kufomat janë bartur me një kamion dhe janë dërguar në Serbi. Pas luftës, përkatësisht deri më 2015, janë kthyer eshtrat e 67 shqiptarëve të vrarë në këtë masakër. (Izet Miftari)

MASAKRA E ZAHAQIT (14 maj 1999). Masakër e forcave të policisë dhe të ushtrisë së Serbisë ndaj popullsisë civile shqiptare në fshatin Zahaq të komunës së Pejës. Forcat serbe më 14 maj 1999, pas fshatit Pavlan, e vazhduan aksionin në drejtim të fshatit Zahaq. Pasi rrethuan fshatin, forca të shumta policore dhe ushtarake hynë shtëpi më shtëpi dhe, duke shtënë me armë, i detyruan banorët të tubohen në qendër të fshatit. Masën e tubuar të fshatarëve, të ngarkuar në kamionë, traktorë dhe makina e detyruan të niset në drejtim të Pejës. Në rrugë e sipër policia ndali kolonën, nga e cila mori 19 meshkuj dhe i ekzekutuan pa ndonjë shkak. Kufomat e të ekzekutuarve gjatë natës ishin dërguar në drejtim të panjohur. Emrat e disa prej të vrarëve të këtij fshati ende gjenden në listën e personave të zhdukur. (Teuta Shala-Peli)

MASAKRA NDAJ FAMILJES BOGUJEVCI (mars 1999). Masakër e kryer nga pjesëtarët e njësisë paramilitare serbe “Shkorpion”, më 28 mars të vitit 1999, me çrast u ekzekutuan 16 civilë shqiptarë të familjes Bogujevci dhe Duriqi në Podujevë. Njësitë rezervë ushtarak “Shkorpion” nxori nga shtëpia familjen

Bogujevci të Podujevës, bashkë me mysafirët e tyre, për t’i dërguar te një kopsht të afërt. Ishin gjithsej 19 persona, fëmijë, gra e pleq. Njësitë ushtarak serb, i përbërë prej 15 vetash i ekzekutuan me armë zjarri civilët e pambrojtur. Pesë prej tyre i mbijetuan masakrës, Saranda Bogujevci 13-vjeçare dhe 4 kushërinjtë, gjithashtu fëmijë. Disa nga pjesëtarët e njësisë “Shkorpion” që kryen krimin janë dënuar nga gjykata në Serbi. (Valdrin Ukshini)

MASAKRA NË PRAPASHTICË DHE KEÇEKOLLË (1921). Masakër e ushtrisë, xhandarmerisë dhe e kolonëve serbë mbi popullsinë civile të disa fshatrave të Llapit dhe Gallapit në janar të vitit 1921. Masakra u bë me motive ndëshkimi dhe u nis nga një batalion i Armatës III serbe, të cilit iu bashkëngjiten njësitë të xhandarmërisë dhe një numër civilësh dhe kolonësh serbë. Me këtë rast u masakruan mbi një mijë shqiptarë të të gjitha moshave, përfshirë gra dhe fëmijë. Sulmi u nis në Popovë të Llapit dhe pastaj vazhdoi në Lupç, Majac, Bellopojë, Tërnavë, Sharban dhe Koliq. Veçanërisht pësuan në masë fshatrat Bellopojë dhe Sharban, ndërsa vetëm në Prapashticë dhe Keçekollë më 11 janar u masakruan 574 shqiptarë. Për këtë masakër e shpërndaun Njoftimin Nazim Gafurri, në emër të Komitetit të Kosovës, dega për Prishtinë. Për këtë masakër shkruan edhe gazetatat “Hak”, “Pravda” e Sarajevës, “Rad”, “Radničke novine”, si dhe “Besa shqiptare”, “Dajti” etj. Për shkak të këtyre shkrimeve, masakra u bë objekt debatesh edhe në parlamente dhe qeveri të Evropës, me çrast u dallua angazhimi i diplomatit britanik, Aubrey Herbert. (Dan Ibrahim)

MASAKRA NË TËRNJ (25 mars 1999). Masakër e kryer nga pjesëtarët e Brigadës së motorizuar 549 të ushtrisë së Jugosllavisë, së bashku me pjesëtarë të tjerë të batalionit të logjistikës, më 25 mars të vitit 1999, me çrast u vranë së paku 27 civilë, banorë të fshatit Tërnj të Suharekës, kryesisht pleq, gra dhe fëmijë, në mesin e të cilëve edhe një djalë i moshës katërvjeçare. Sipas aktakuzës të ngritur për këtë rast, urdhrin për masakër e ka dhënë një oficer aktiv i ushtrisë së Serbisë, ndërsa ekzekutimin e kanë bërë persona që kanë qenë në varshmëri të tij. (Valdrin Ukshini)

MASAKRA NË ZAGORTH-DUMNICË TË VUSHTRISË (1924). Njëra ndër masakrat serbe ndaj popullsisë civile shqiptare. U ndër-mor në ndjekje të Mehmet Konjuhiti, i cili ishte pjesëtar i lëvizjes kaçake. Me qëllim që t'i zërë të gjallë prijësin e kaçakëve dhe bashkëlufëtaret e tij, forcat e xhandarmërisë serbe rrethuan shtëpitë e Konjuhëve, Bajçinovcëve dhe të Igrishtasve, duke ua vënë zjarrin shtëpive dhe duke shtënë me armë mbi këdo që shihnin. Në këtë masakër u vranë dhe u dogjën në zjarr 11 anëtarë të familjes Konjuhi, 8 veta nga familja Mulaku, 2 veta nga familja Bajçinovci dhe 2 veta nga familja Igrishta. Midis të vrarëve kishte të moshuar, gra dhe fëmijë, përfshirë edhe një foshnje 9-muajshe. Në këtë rrethim u plagos edhe Mehmet Konjuhi, por nuk u kap nga forcat serbe. (Liman Rushiti).

MASAKRAT E LYBENIQIT (1998-1999). Masakër e forcave ushtarake dhe policore të Serbisë, e kryer ndaj banorëve civilë të fshatit Lybeniq afër Pejës dhe rreth tij. Në këtë fshat janë kryer tri masakra nga forcat ushtarake dhe policore të Serbisë. Masakra e parë është kryer më 25 maj 1998, kur forcat ushtarake-policore serbe ndërmorën një ekspeditë ndëshkimore kundër fshatit. Pas granatimeve nga baza ushtarake e Zagermës, njësitet speciale të policisë serbe hynë në fshat, plaçkitën, dogjën një pjesë të fshatit, ekzekutuan 9 civilë dhe i plagosën 3 të tjerë. Gati një vit më vonë, më 1 prillit 1999, forcat ushtarako-policore dhe paramilitare serbe, së bashku me serbët e malazezët vendës, sulmuan sërish fshatin Lybeniq. Që në orët e hershme të mëngjesit, forca serbe granatuan fshatin nga baza ushtarake e Zagermës dhe nga rruga magjistrale Pejë-Deçan. Më pas forcat e këmbëorisë i nxorën nga shtëpitë e tyre banorët e fshatit, gratë, pleqtë dhe fëmijët, që ishin strehuar nëpër bodrume. Masës së grumbulluar në qendër të fshatit ua shkatërruan dokumentet e identifikimit dhe ua plaçkitën çdo gjë me vlerë. Njëkohësisht e bënë veçimin e rreth 80 burrave dhe të rinjve, të cilët më pas i ekzekutuan, kurse gratë, pleqtë dhe fëmijët i urdhëruan të merrnin rrugën për Shqipëri. Në rrugë e sipër, njësitë që bënte ekzekutimet, pas urdhrit që mori nëpërmjet radiolidhjes zbrazti breshëri rafalësh në drejtim të masës, duke i ekzekutuar pjesën dërmuese të të ndaluarve: 66 mbetën të vrarë, ndërkaq 12 të tjerë u plagosën, duke

u shtirë si të vdekur. Disa ditë më pas, më 7 prill 1999, në vendin e quajtur te Stanet e Belit në bjeshkët e Lybeniqit, ku kishin mbetur të ngujuar shumë civilë duke kërkuar shpëtim, u rrethuan nga njësitet ushtarake të Serbisë, me ç' rast i vrasin edhe dhjetëra civilë të tjerë, prej tyre 9 banorë të Lybeniqit, 18 nga Raushiqi, 10 nga Buçani e disa të tjerë nga fshatrat tjera të Pejës dhe Deçanit, duke i vrarë, duke ua prerë kokat dhe duke i hedhur në greminë. Një pjesë e kufomave të të vrarëve në masakrat e Lybeniqit janë gjetur në grykën e quajtur Ujvara e Lybeniqit, një pjesë në varrezat e Pejës, disa janë gjetur në varrezat masive në afërsi të Beogradit, por një numër ende konsiderohen të zhdukur. (Fetnete Ramosaj)

MASAKRAT NË RAJONIN E MITROVICËS (1998-1999). Masakra të forcave ushtarake dhe policore të Serbisë mbi popullsinë civile shqiptare në disa zona të rajonit të Mitrovicës, për të thyer luftën e UÇK-së dhe për të bërë spastrimin etnik të kësaj pjese të Kosovës. Njëra prej tyre ishte masakra e Shalës së Bajgorës, më 15, 16 dhe 17 shtator 1998. Forcat policore dhe paraushtarake serbe, pasi dogjën dhe shkatërruan shumë shtëpi e objekte të ndryshme, pushkatuan 14 shqiptarë, kryesisht gra, fëmijë dhe pleq. Po në shtator të vitit 1998 ndodhi edhe masakra e Çiçavicës (22-24 shtator 1998). Forcat serbe ekzekutuan dhe vranë 24 shqiptarë. Masakra në Tregun e Gjelbër në Mitrovicë u bë më 3 mars 1999, kur forcat ushtarake-policore serbe granatuan qendrën e qytetit të Mitrovicës të banuar kryesisht me shqiptarë (Tregun e Gjelbër). Nga ky granatim, që u bë nga pika më e lartë, e quajtur Zveçan i Vogël, u vranë 6 shqiptarë dhe 128 u plagosën rëndë, shumica prej të cilëve mbetën invalidë të përjetshëm. Masakra serbe në Rrugën e Kovaçëve ndodhi më 14 prill 1999, kur forcat serbe ndërmorën një aksion të përgjithshëm për dëbimin e të gjithë shqiptarëve nga shtëpitë e banesat e tyre. Gjatë këtij aksioni vetëm në Rrugën e Kovaçëve u vranë 39 shqiptarë të moshave të ndryshme. Ndërsa në masakrën e Drethit (1999) u ekzekutuan 23 shqiptarë, kryesisht me arsimim të lartë. Ata u arrestuan në afërsi të fshatit Dreth dhe, me urdhër të komandës ushtarake lokale, u ekzekutuan që të gjithë. Kufomat e tyre janë varrosur në një varrezë masive, e cila ende nuk është identifikuar. Në ditët e fundit të pushtetit serb

në Kosovë, në Mitrovicë, në dy lagje të qytetit “7 Shtatori” dhe “Tbri” më 9 qershor 1999 u ekzekutuan 31 shqiptarë nga forcat serbe. Masakra u bë për hakmarrjeje, për humbjet që pësuan forcat ushtarake-policore serbe nga NATO-ja dhe UÇK-ja. (Fazli Hajrizi)

MASAKRAT SERBE NË KOSOVË 1918-1924. Masakra serbe ndaj popullsisë shqiptare, të cilat filluan më 1912 dhe vazhduan me intensitet më të madh me ripushtimin e Kosovës më 1918. Sipas shënimeve të Komitetit “Mbrotjtja Kombëtare e Kosovës”, vetëm në janar-shkurt 1919 serbët në Kosovë ekzekutuan mbi 13,000 shqiptarë dhe dogjën fshatra të tëra me mbi 6,400 shtëpi. Masakrat më të mëdha serbët i kryen në rrethet e Prishtinës (4,600 të vrarë, 2164 shtëpi të djegura) dhe të Vushtrisë (2,179 të vrarë, 1,463 shtëpi të djegura), ndonëse nuk mbetën pas as rrethet e tjera, si ai i Pejës, i Prizrenit, i Gjilanit, i Llapit, i Ferizajit etj. Me arsyetimin e konsolidimit të pushtetit, por më shumë për hakmarrje shoviniste dhe për shfarosjen në masë të shqiptarëve, pushteti serb ndërmoi fushata të vazhdueshme vrasjesh, plaçkitjesh dhe të dëbimit me dhunë të popullsisë së pambrojtur. Vetëm gjatë viteve 1918-1921 në Kosovë dhe përreth saj u vranë me mijëra shqiptarë, u keqtrajtuat dhe u burgosën mijëra të tjerë, u dogjën, u plaçkitën dhe u shkatërruan fshatra të tërë. Masakrat serbe shoqëroheshin edhe me dëbimin e popullsisë në llogore, si në Nish, Zajëçar, Kragujevc etj., apo me shpërngulje për në Turqi dhe Shqipëri. Për mizoritë serbe njoftonte edhe shtypi shqiptar dhe ndërkombëtar, por edhe ai serb. Më 1925 gazeta beogradase “Rad” (5 gusht 1921) shkruante se si Punisha Raçiqi i vriste gratë dhe fëmijët shqiptarë nga gjashtë me një plumb. Vetëm në masakrën e Prapashticës nga 6-8 janar 1921 dhe në 13 fshatra të Llapit u vranë mbi 1,080 veta dhe u plaçkit çdo gjë. Në atë fshat më pas u vendosen 25 familje serbe, të cilat ruheshin me xhandarmëri. Ndërkaq, nga 13-15 janar me topa u shkatërrua fshati Kollë i Vushtrisë dhe Kërrnina e Istogut, që për 20 vjet mbetet shkret, deri më 1941, kur banorët u kthyen nga Turqia dhe Shqipëria. Fatin e këtyre fshatrave e patën edhe dhjetëra të tjera. Më 14 shkurt 1924 në Zagori sulmohet Mehmet Konjuhi, me çrast masakrohen 23 anëtarë të familjes Mulaku, vëllezërit Bajçinovci dhe u vranë disa anëtarë të kësaj familjeje. Edhe më

12 mars 1924 u krye sulmi në xhaminë e Polacit, ku u vranë disa bashkëluftëtarë të Azem Bejtës. Më 15 korrik sulmohet me 200 trupa ushtarake dhe xhandarmërie Arbania e Vogël e Azem Galicës, me çrast shkatërrohen deri në themel Galica, Mikushnica e Lubaveci. (Liman Rushiti)

MATIJSHEVIQ Jellka (Jelka Matijašević) (1939-). Gjuhëtare, sllaviste, profesore. U diplomua në Beograd (1963) në departamentin e rusishtes. Ka interesime studimore të kontrastimit të rusishtes me serbishtes në leksikologji dhe morfologji. Ishte profesore ordinare e Universitetit të Prishtinës dhe dekane e Fakultetit të Filologjisë. Në vitet '90 kaloi me punë në Universitetin e Novi-Sadit. Ndër punimet e saj kryesore janë studimet për dukuritë konvergjente të morfologjisë së rusishtes dhe të serbishtes (1996), për derivacionin (2000) dhe për leksikologjinë deskriptive të gjuhës standarde dhe bazat e saj teorike (2002). (Naile Mala-Imami)

MATKOVSKI Aleksandar (1922-1992). Historian, orientalist, akademik. Lindi në Krushëvë të Maqedonisë. Në vitin 1952 diplomoi për histori në Fakultetin Filozofik në Shkup, ndërsa më 1957 doktoroi në Fakultetin Filozofik të Zagrebit. Më pas studioi orientalistikë me filologji në Universitetin e Beogradit. Punoi në seksionin e periudhës osmane-turke në Institutin e Historisë Nacionale në Shkup. Është autor i shumë veprave shkencore për historinë e Ballkanit. Ndër veprat më të rëndësishme janë: “Rezistenca në Maqedoni gjatë kohës së sundimit turk” në katër vëllime, pastaj “Kanunet dhe fermanet” etj. Vepër e rëndësishme e A. Matkovskit është “Kryengritja e Dervish Carës”, e cila u botua edhe në gjuhën shqipe nga “Flaka e vëllazërimit” në Shkup (1985). (Skënder Asani)

MATOSHI Adriana (1980-). Aktore. Lindi në Gjilan, ku kreu arsimin fillor dhe të mesëm. Kreu studimet për aktrim në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës (2004). Fillimisht, në Teatrin “Dodona”, në Prishtinë, ka luajtur në disa komedi të lehta, si: “Ti dhe vetëm ti”, “N’dorë e ka deputeti” dhe “Profesor, jam talent se jo mahi (5)”. Shfaqja “Mësimi” (2002), ku ajo luan rolin e nxënëses, shënon një kthesë profesionale në krijimtarinë e saj



ADRIANA
MATOSHI

artistike. Në këtë teatër ka luajtur edhe në shfaqjen monodramë “Gruaja në kornizë”. Në Teatrin Kombëtar të Kosovës ka luajtur në shfaqjet “Trën dafili tatuazh”, “Mosmarrëveshja”, “Pallati i ëndrrave”, “Shtëpia e Bernarda Albës”, “Menaxheria e qelqtë”, “Pinokio”, “Daysiland”, “Mbreti Lir” etj. Luajti edhe në Teatrin e Gjilanit (“Romeo e Zhuljeta”, “Kumbara” etj.). Ka luajtur edhe në teatrot dhe trupat alternative dhe në disa filma të metrazhit të gjatë, si “Babai” dhe “Martesa”, në filmat e metrazhit të shkurtër: “Ok”, “Kaona”, “Gruaja”, “Kthimi” etj., si dhe në serialin televiziv “Kafeneja jonë”. U nderua me çmime dhe mirënjohje: çmimi “Adriana” si aktorja më e mirë në Festivalin Ndërkombëtar Studentor “Skena UP” (Prishtinë, 2004), për rolin në filmin “Kthimi” me çmimin “Aktorja më e mirë”, në “Film Lab Festival” (2012) në Brescia (Itali) etj. (Bekim Lumi)

MATOSHI Albatrit (1988-). Gazetar. Lindi në Prishtinë. Shkollën fillore e kreu në Hajvali, ndërsa të mesmen në Prishtinë. Më pas vijoi studimet në Fakultetin e Filologjisë, dega e gazetarisë në Universitetin e Prishtinës. Kreu studimet në vitin 2010, kur edhe u punësua në të përditshmen sportive “Topi”. Më pas e vazhdoi karrierën si gazetar i sportit në të përditshmen “Zëri”. (Florim Maliqaj)

MATOSHI Driada (1985-). Aktore. Lindi në Gjilan. Shkollimin bazë e mori në vendlindje, kurse studimet për aktrim i kreu në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. Punoi si gazetare për disa vjet. Luajti në një sërë shfaqjesh teatrore, ndërsa luajti role kryesore në shfaqjet “Sakati nga Inishmani” (2010), “Nata e dymbëdhjetë” (2012), “Vetmi në Perëndim” (2012), “Shtëpia në ankand” (2013) etj. Po ashtu luajti në disa seriale televizive dhe në filmat artistikë: “Gjallë” (2009), “Komuna e Parisit (2010) dhe “Lagjja e re” (2011). Është laureate e çmimeve në festivale të teatrit shqiptar në Ferizaj (2011) dhe në Dibër (2012) për rolet në “Sakati nga Inishmani” dhe “Shtëpia në ankand”. (Visar Krusha)

MATOSHI Halil (1961-). Poet, prozator, publicist. Lindi në fshatin Gmicë të Kamenicës.



HALIL MATOSHI

Kreu shkollën fillore në vendlindje, të mesmen në Kamenicë, ndërsa studimet për filozofisociologji në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Punoi si gazetar dhe redaktor në revistën “Zëri i rinisë” dhe më pas në gazetën “Zëri” dhe në medie të tjera në Kosovë. Gjatë luftës së Kosovës ishte i zënë peng nga forcat serbe të sigurisë dhe vuajti rreth një vit në kampin e përqendrimit “Zabela” në Pozharevc të Serbisë. Shkruan poezi, tregime dhe eseistike. Është autor i librave: “Frymë varresh në dallgore”, poezi (1988); “Udhëtim nëpër ëndërr të keqe”, libër mikst (1994); “Lajmësi memec”, tregime (1996); “Udhëtim nëpër zhgjiëndërr të keqe”, ditar lufte dhe ese (2005); “Hija e Krishtit”, poezi (2004); “Katedralë letre”, studime, ese dhe tregime (2012); “E pabesueshme”, poezi (2013); “Pesë breza ushtar Kosove”, monografi (2013); “N’zanafillë” (Shëja stilistike për gjanat e (pa)harrume), poezi (2014). (Agron Gashi)

MATOSHI Hysen (1935-2002). Gazetar. Lindi në fshatin Gmicë të komunës së Kamenicës. Shkollën fillore e kreu në Gjilan, ndërsa shkollën normale në Prishtinë. U caktua mësues dhe drejtor i shkollës fillore në fshatin Zhegër afër Gjilanit. Më pas nisi punën në gazetën “Rilindja”, korrespondent nga komuna e Gjilanit. Në vitin 1960 u bë korrespondent i “Rilindjes” nga Mitrovica, ndërsa nga viti 1983 në redaksinë qendrore në Prishtinë. Disa vjet udhëhoqi arkivin e kësaj gazete. Pas mbylljes së “Rilindjes” (1990) vazhdoi të punojë në gazetën “Bujku” dhe njëkohësisht në Qendrën për Informim të Kosovës, gjithashtu si udhëheqës i dokumentacionit. (Nehat Islami)

MATOSHI Hysen (1967-). Studiues i letërsisë. Lindi në Gmicë të komunës së Kamenicës. Studimet i kreu në degën e letërsisë dhe të gjuhës shqipe në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Prishtinës (1990). Studimet pasuniversitare dhe disertacionin e kreu po në Prishtinë (2005). Është autor i një sërë shkrimesh të botuara në periodikun letrar dhe shkencor të Kosovës, të Shqipërisë, të Maqedonisë etj. dhe ka marrë pjesë në një sërë aktivitetesh shkencore brenda dhe jashtë vendit. Është autor i disa

monografive studimore dhe i përmbledhjeve të studimeve dhe vështrimeve kritike: “Poezia e Lasgush Poradecit në kontekstin e poezisë evropiane” (2000), “Shqyrtime letrare” (2005), “Stilet në letërsinë shqipe ndërmjet dy luftërave botërore” (2008), “Hapësira etnike e kulturore shqiptare dhe Kisha Ortodokse Serbe/Albanian cultural space and the Serbian Orthodox Church” (botim dygjuhësh, 2012). “Qasje albanologjike” (2016). Është drejtor i Institutit Albanologjik të Prishtinës nga viti 2007. (Nehat Krasniqi)

MATOSHI Liman (1947-). Studiues i letërsisë, profesor universiteti. Lindi në fshatin Gmicë të Kamenicës, ku kreu shkollimin fillor. Kreu shkollën e mesme në Gjilan, ndërsa studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin Filozofik të Prishtinës. Po në këtë fakultet më pas kreu studimet pasuniversitare dhe mbrojti tezën e doktoratës (1985). Më 1974 u zgjodh asistent në degën e gjuhës dhe të letërsisë shqipe për lëndën letërsi e sotme shqipe, ku më pas mori gradat përkatëse universitare. Mori pjesë në tribuna, konsulta, simpoziume e konferenca shkencore për letërsinë, të organizuara në Kosovë dhe në Shqipëri dhe ishte profesor-mysafir në Universitetin e Jenës dhe të Sofjes. Ushtri detyra dhe funksione të ndryshme në institucionet e shkollimit të lartë. Ishte kryeredaktor i revistës “Filologji”, sekretar shkencor dhe drejtor i Seminarit Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare etj. Botoi veprat: “Poema e sotme shqipe” (1978), “Struktura e poezisë patriotike shqipe” (1985), “Poezia atdhetare shqipe, prej fillimit deri te Lufta e Dytë Botërore” (2002). (Isak Shema)

MATOSHI Naim (1976-). Inxhinier i arkitekturës. Lindi në Gmicë të Kamenicës, shkollimin fillor e kreu në Tugjec, kurse shkollën e mesme teknike në Prishtinë. Kreu studimet për arkitekturë në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe të Arkitekturës të Universitetit të Prishtinës (2007). Fillimisht u punësua në kompaninë projektuese të arkitekturës “Nixha Partners” (2001). Më pas, së bashku me tre partnerë themeloi studion projektuese “Pro ing center”, në kuadër të së cilës veçohet projekti për terminalin doganor të Dheu i Bardhë në Kamenicë. Më 2003 së bashku me partnerë themeluan kompaninë projektuese “Horizons

Group”, e cila mori pjesë në shumë projekte dhe konkurse, si: objekti i ekspoziturës dhe i administratës së kompanisë “Fortesa”, Fakulteti i Edukimit, plani urbanistik arkitektonik “Ulpiana”, plani urbanistik arkitektonik i lagjes “Dodona”, plani urbanistik i lagjes “Marigona residence” etj. Në vitin 2009 themeloi studion “Arcadis”, në kuadër të së cilës projektoi shumë projekte, si: vila luksoze, komplekse ndërtimi, objekte administrative etj.. (Dervish Qerreti).

MATOSHI Sanije (1976-). Mezosoprano. Kreu shkollimin e mesëm muzikor në Prishtinë (1994), studimet për kanto, bashkë me ato pasuniversitare i kreu në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës, në klasën e prof. Ahmet Dërgutit. Në vitet 2004-2006 ishte soliste në Teatrin Shtetëror të Operës e Baletit në Novosibirsk (Rusi), pastaj soliste dhe anëtare e korit të Filarmonisë së Kosovës. Aktualisht vijon studimet e doktoratës nga këndimi operistik në Universitetin e Ri në Sofje. Ka përfunduar masterklasa me specialistë të këndimit operistik (E Blahova, Vjenë, O Arandez e H Branisteanu, Salsburg). Është paraqitur në koncerte solistike e kamerale dhe në festivale të ndryshme në vend dhe në rajon. Është profesore e solokëndimit në Fakultetin e Arteve të UP-së. (Besa Luzha)

MATRËNGA Lekë (Luka, rreth 1567-1619). Autor arbëresh nga Hora e Arbëreshëve apo Monreale, Sicili. Matrënga kishte mësuar në kolegjin grek në Romë për pesë vjet, për t'u



LEKË MATRËNGA

kthyer sërish në Sicili, ku nga 1591 ka nisur shërbimin priftëror. Vepra e tij “E mbsuame e krështerë” (1592) si dorëshkrim është ruajtur në tri versione. Ka dhe një version të shtypur. Vepër mësimi kishtar. Ka përkthyer arbërisht katekizmin e priftit jezuit spanjoll Jacob Ledesma (1516-1575). Titulli i botimit: “E mbsvame e chræsteræ bææræ per tæ vrtænæ atæ Ladesmæ sciochiæræit jesusit. E prierræ lætæriæt mbæ gluchæ tæ arbæresciæ pær Lecæ Matrængnæ i mbsvam i cullegit græcæ tæ Romæsæ” (Dottrina christiana composta dal reverendo p. dottor Ledesma della compagnia Giesù. Tradotta di lingua italiana nell’albanese

per Luca Matranga alunno del collegio. (E mbsuame e krështerë bërë për të urtënë Atë Ladesmë shoqëriet Jezusit. E prierë lëtirëjet mbë gluhë të arbëneshë për Lekë Matrëngnë i mbsuam i Kulexhit grëkë të Romësë). Është autori i parë arbëresh. Ka lënë një vjershë, e cila nuk ishte botuar në librin e vitit 1492, por ruhej në dorëshkrimin 1 të veprës. “E mbsuame e krështerë” është botuar në kohët e reja nga Marco La Piana (1912), bashkë me të dy dorëshkrimet e tjera nga Mateo Shambra (Matteo Sciambra) (1964), nga Selman Riza (1960, dorëshkrim i ri 1966 i botuar më 2002) dhe së fundi bashkë edhe me libërthin e botuar nga Fadil Sulejmani (1979). Tani Matteo Mandalà ka bërë botim të ri kritik me trajtim tekstor modern (“Luca Matranga, E mbsuame e krështerë”, 2004). Studim të gjerë kemi dhe te Joachim Matzinger (“Die Altalbansiche Text Mbsuame e krështerë (Dottrina cristiana) des Lekë Matrënga 1952”, Dettelbach 2006). Është vënë re se vjersha “Canzona spirituale” është përkthim, çka nuk ia ul vlerën, jo vetëm historike, po edhe letrare. Janë tetë vargje njëmbëdhjetërokëshe të rimuara ABAB. Matrënga përdorte vetëm shkronja latine: *-th*-në e shënoi si *sot*, ndërsa *dh*-në me *d*; *-sh*-në e shënoi me *x*; *-ë*-në e dha me *æ*; *-x* te *nxjerrë* e shënoi me *gz*: *ngzierræ*, khs.me Buzukun; me dyfishim zanoresh shënoi gjatësinë: *graa*, *i chrextee*, *pær chijr*, *cuur*; *-nj* dhe *l* të qiellzorëzuara arbëreshe i shënonte me *gn*, *gl*; *q=ch(i)*; *-gj=cghi*, sidomos para *a*, *u*. Gjuha e Matrëngës nuk dallon shumë nga gjuha e autorëve të tjerë të vjetër, pos që është e dialektit toskë dhe me shumë greqizma, për pasojë të mërgimit nëpër More. (Rexhep Ismajli)

MATURA. Provimi i diplomës në shkollë të mesme, që ndryshe quhet provim i pjekurisë. Kur gjimnazi ishte shkollë e mesme tetëvjeçare, ekzistonte “matura e vogël” dhe “matura e madhe”. Atë e organizonte shkollë përkatëse për nxënësit e vet. Ishte provim i brendshëm. Në vitin 2006 në shkollat e Kosovës filloi të realizohet provimi i maturës shtetërore, në organizimin, mbikëqyrjen dhe vlerësimin e shërbimeve përkatëse profesionale të Ministrisë së Arsimit të Shkencës dhe të Teknologjisë. Ky është provim i jashtëm dhe synon unifikimin e provimit të diplomimit në shkollë vendi. Në vitin 2008 u miratua Ligji për maturën. (Vlora Sylaj)

MAVRAJ Muhamet (1971-). Gazetar. Lindi në Saradran të Istogut, ku kreu arsimin fillor. Shkollën e mesme e kreu në Burim, ndërsa në Universitetin e Prishtinës studioi shkencat politike dhe shkencat e komunikimit. Kreu studimet pasuniversitare për marrëdhënie ndërkombëtare dhe për gazetari dhe vijoi studimet e doktoraturës po në këto fusha në Tiranë dhe në Prishtinë. Ishte organizator demonstratash në Istog, ndihmoi aksionin e pajtimit të gjaqeve dhe Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Ishte njëri nga prijësit e “Lëvizjes studentore” (1997-1998), ndërkohë ishte kryeredaktor i gazetës së studentëve “Bota e re”. Në vitin 1998 arriti pajtim me “Zërin e Kosovës”, që botohej në emigracion, për botimin e shkrimeve të njëjta për luftën. Është bashkëthemelues i Partisë Demokratike të Kosovës (1999), ndërsa më pas u tërhoq në fushën e gazetarisë dhe të veprimtarisë studimore. Më 1999 themeloi gazetën e përditshme “Epoka e re” dhe vazhdon të jetë botues i saj. Merret me poezi (“Buzëqeshje në ëndërr”, 1994) dhe me studime nga fusha të ndryshme. Ligjëron për gazetari dhe shkencat politike në institucionet e arsimit të lartë. (Ibrahim Berisha)

MAVRIQI Ramush (1949-). Filozof, profesor universiteti. Lindi në Kamenicë, ku kreu shkollën fillore dhe gjimnazin. Studimet për filozofi i kreu në Universitetin e Beogradit. Në vitet



RAMUSH MAVRIQI

1978-1979, si bursist i DAAD-së, bëri studime shpesh në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Frankfurtit mbi Majn, Gjermani. Vijoi studimet e magjistraturës në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Zagrebit, ku më 2001 doktoroi në fushën e shkencave të filozofisë. Karrierën universitare e filloi si asistent për lëndët filozofi në vitin 1976, mandej u avancua në të gjithë titujt universitarë, përfshirë edhe titullin e profesorit të rregullt në departamentin e filozofisë të Fakulteti Filozofik të Universitetit të Prishtinës (UP) për lëndët: filozofia klasike gjermane, bazat e etikës, histori e etikës, pastaj për historinë e filozofisë politike në departamentin e shkencave politike. Ligjëroi lëndë filozofike edhe në Fakultetin e Mjekësisë dhe atë

Ekonomik të UP-së. Kreu detyra dhe funksione me përgjegjësi në institucionet e arsimit të lartë, përfshirë edhe detyrën e dekanit të Fakultetit Filozofik të UP-së. Është autor i librit “Poiesis e Praxis” dhe i teksteve dhe artikujve shkencorë nga fusha e filozofisë, botuar brenda dhe jashtë vendit. Ishte koordinator dhe udhëheqës i disa hulumtimeve empirike të Institutit për Filozofi dhe Sociologji. (Anton K. Berishaj)

MAXHERA Arsim (1982-). Gazetar i sportit. Lindi në Mitrovicë. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje. Studioi shkencat sportive në Universitetin e Prishtinës. Nisi karrierën e gazetarit sportiv në vitin 2002, në gazetën “Kosova sport”. Në këtë medium qëndroi deri në vitin 2003. Nga viti 2004 u punësua në gazetën “Koha ditore”, ku ende vazhdon të punojë. Në vitin 2016 ka botuar librin “Majlinda, kronikë e suksesit të një supersportisteje”, kushtuar kampiones europiane, botërore dhe olimpike, xhudistes Majlinda Kelmendi. (Leutrim Mustafa)

MAXHERA Ejup (1940-). Bjeshkatar. Lindi në Bardh të Madh, ku kreu shkollimin fillor, ndërsa në Prishtinë kreu shkollën e mesme dhe Fakultetin e Kulturës Fizike. Që në moshë të re filloi të merret me sport, fillimisht me atletikë e më pas për shumë kohë i kushtohet bjeshkatarisë. Për 15 vjet ishte në krye të shoqërisë bjeshkatore “Gërmia”. Në vitin 1969 emërohet sekretar i Lidhjes së Organizatave për Kulturë Fizike në komunën e Prishtinës, ku qëndroi deri në vitin 1990. Gjatë kësaj kohe organizoi ekspedita të ndryshme në vend dhe në disa shtete të Ballkanit, të Europës dhe të Azisë. Për dy vjet (1974-76) ishte trajner i klubit të hendbollit “Prishtina”. Në vitin 1991 ishte ndër nismëtarët për pavarësimin e sportit të Kosovës. Në periudhën 1996-2000 ishte sekretar i Federatës së Sporteve të Kosovës, kurse në vitin 2000 themeloi Federatën Bjeshkatore-Alpiniste të Kosovës, në krye të së cilës qëndroi 12 vjet. Më pas u emërua edhe kryetar nderi i kësaj federate. Është nderuar me mirënjohje për zhvillimin dhe masivizimin e sportit në Kosovë. (Baki Berisha)

MAXHERA Hoxhë Sinan (1863-1910). Veprimtar i Lëvizjes Kombëtare. Lindi në fshatin Maxhere të Karadakut të Preshevës. Kreu medresenë në Shkup dhe vazhdoi studimet për drejtësi në Stamboll. Mori pjesë në luftë

kundër ushtrisë greke, ku qe i plagosur. Punoi si hoxhë në disa fshatra të kazasë së Gjilanit. Ishte bashkëluftëtar i Idriz Seferit në Betejën e Kaçanikut dhe të Moravës së Epërme. Meqë gëzonte autoritet në popull, luajti rol të rëndësishëm edhe në pajtimin e gjaqeve dhe në zhdukjen e hakmarrjes. Pas shuarjes së kryengritjes, qeveria xhonturke organizoi ekspedita ndëshkimore kundër kryengritësve shqiptarë. Krahas shumë pjesëmarrësve dhe udhëheqësve të kryengritjes, S. Maxhera u arrestua në Preshevë. Gjykata ushtarake xhonturke e dënoi me vdekje së bashku me 6 kryengritës të tjerë. Mulla Sinani u var në Kaçanik më 7 korrik 1910 dhe u varros në varrezat e vjetra të këtij qyteti. (Aliriza Selmani)

MAXHUNI Hysni (1943-). Futbollist, trajner. Lindi në Mitrovicë, në moshën 17-vjeçare iu bashkua skuadrës së “Trepçës”, pasi u zbulua në një turne të futbollit të vogël. Prej vitit 1960 e deri më 1972 luajti në rolin e mesfushorit të djathtë dhe ishte shënues i spikatur te kjo skuadër në ligën e Kosovës, Serbisë dhe në ligën e dytë federative të ish-Jugosllavisë. Në vitin 1972, shkaku i lëndimit, u tërhoq nga futbolli aktiv dhe vazhdon karrierën si trajner. Për dhjetë vjet qëndroi te “Trepça”, të cilën e drejtoi në finalen e Kupës së ish-Jugosllavisë. Pas “Trepçës” mori drejtimin e “Lirisë” së Prizrenit, i cili në edicionin e parë e kualifikoi në ligën e dytë të ish-Jugosllavisë. Pastaj erdhi në “Prishtinë” për tetë vjet, kurse punoi edhe në Turqi te skuadrat “Genclerbirliği”, “Konyaspor” e “Kirkarelispor”. Po ashtu, drejtoi edhe skuadrat shqiptare të Maqedonisë, si: “Bashkimi” i Kumanovës dhe “Shkëndija” e Tetovës. Ishte në krye pothuajse të shumicës së skuadrave të Kosovës. (Arsim Maxhera)

MAZREKAJ Curr (1947-). Gazetar. Lindi në Drenoc, komuna e Deçanit. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, të mesmen në Pejë. Studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe i mbaroi në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Punën në gazetari e nisi më 1974, në gazetën “Rilindja”, katër vjet në selinë e redaksisë në Prishtinë e pastaj korrespondent nga Deçani. Në “Rilindje” punoi deri më 1990, derisa gazeta u mbyll nga Serbia, dhe pastaj vazhdoi në gazetën “Bujku”. Punën e korrespondentit nga Deçani e vazhdoi edhe pas luftës, gjatë kohës që doli “Rilindja” dhe më

pas në gazetën “Zëri”. Për zhvillimet në zonën e Deçanit gjatë viteve 1998-99 raportoi edhe për Televizionin Shqiptar, për emisionet në gjuhën shqipe të radiove BBC dhe “Deutsche Welle”. Mori një sërë mirënjohjesh dhe çmimesh për punë profesionale. (Zenun Çelaj)

MAZREKU Engjëll (1942-2001). Inxhinier i xehetarisë. Lindi në Prizren, ku kreu shkollimin fillor dhe të mesëm, ndërsa studimet i kreu në Fakultetin e Xehetarisë dhe të Gjeologjisë në Universitetin e Beogradit (1967). Pas diplomimit punësohet si inxhinier në minierën e linjitet në Mirash. Në periudhën 1968-1990 në Korporatën Elektroenergjetike të Kosovës kreu një varg funksionesh me rëndësi: inxhinier kryesor i shërbimit elektrik në drejtorinë e qymyrit, drejtor i minierës “Bardh i Madh”, drejtor i institutit “Inkos” etj. Nga vitet 1990-1999 merret me biznes privat në Zagreb (Kroaci). Në vitin 1999 kthehet në Kosovë dhe merr detyrën e drejtorit të departamentit të prodhimit në Korporatën Elektroenergjetike të Kosovës dhe anëtar i bordit menaxhues të Korporatës Elektroenergjetike të Kosovës (KEK). Në vitin 2000 u zgjodh drejtor gjeneral i KEK-ut. E. Mazreku ishte anëtar i shumë organizmave dhe komisioneve profesionale në nivel vendi, si: anëtar i komisionit për verifikimin e rezervave minerale të Kosovës, redaktor profesional i revistës shkencore “KXEMK” (publikim i Institutit “Inkos”) etj. (Shyqeri Kelmendi)

MAZREKU Imzot Matej (1726-1808). Argjipeshkëv. Lindi në Janjevë. Mësimet i filloi në Kolegjin Ilirik të Shën Palit e Shën Pjetrit në Ferma të Italisë dhe i vazhdoi në kolegjin Urbanian në Romë, ku dhe i përfundoi studimet për teologji (1746). Sipas raporteve të kohës, në vitin 1756 ishte famullitar i Janjevës dhe vikar gjeneral i Argjipeshkvisë Shkup-Prizren. Me dekretin e Kongregatës së Shenjtë, më 1758 u emërua argjipeshkëv i Argjipeshkvisë Shkup-Prizren. Shugurimi i tij u bë në Dubrovnik në vitin 1759. Raportet që M. Mazreku ia dërgon Selisë së Shenjtë flasin për gjendjen e vështirë të Argjipeshkvisë Shkup-Prizren, për plaçkitjen dhe rrënimin e kishave, për islamizimin me dhunë të shqiptarëve etj. Vdiq në Janjevë, pas një sëmundjeje të gjatë. (Sarë Gjergji)

MAZREKU Imzot Pjetër (1584?-1634). Titullar i Kishës Katolike. Lindi në Prizren. Burime

kishtare njoftojnë se që më 1617 ishte vikar apostolik i Argjipeshkvisë së Tivarit. Më 1622, nga Selia Shenjtë u propozua në krye të Dioqezës së Prizrenit, por ipeshkëv u shugurua dy vjet më vonë, për arsye se gjatë asaj periudhe kishte vizita apostolike në vendet ballkanike (Bosnjë, Serbi, Bullgari, Hungari etj.). Nga këto vizita i raportoi Selisë së Shenjtë mbi gjendjen e përgjithshme në këto vende. Për Dioqezën e Prizrenit shkruan me një dashuri të veçantë e plot dhembje. Raportoi për shkaqet e islamizimit të shqiptarëve dhe i propozoi Kongregatës së Shenjtë hapjen e shkollave e të seminarëve, ku do të shkolloheshin gjeneratat e reja. Në një raport të vitit 1633, ndër të tjera, njoftoi se në vitin 1592 turqit kishin djegur libra shumë të vjetra dhe kishin bërë dëme të mëdha në Dioqezën e Shkupit. Në një nga raportet janë shënuar 32 fjalë shqipe, për të cilat ai orvatet të japë etimologji dhe shpjegime. Në kushtet e vështira të sundimit otoman organizoi dhe disa sinode kishtare, me qëllim të përmirësimit të gjendjes së kishës dhe të popullit. Në vitin 1624 u emërua argjipeshkëv i Tivarit dhe administrator i Serbisë, ndërsa në vitin 1631 edhe administrator i Hungarisë. Vdiq në Shkup. (Sarë Gjergji)

MBLEDHJA GJUHËSORE E VITIT 1952. Mbledhja e parë e mbajtur në Kosovë për çështjen e caktimit të gjuhës së shkruar shqipe dhe të drejtshkrimit të saj për shqiptarët në ish-Jugosllavi. Me nismën e Pleqësisë Krahinore të Arsimit dhe të Kulturës, në nëntor u mblodhën njohës të gjuhës: arsimtarë, shkrimtarë, publicistë nga Kosova dhe vise të tjera etnike shqiptare në Jugosllavi dhe trajtuan çështje të gjuhës së shkruar shqipe që përdorej në shkrimet e shqiptarëve të Kosovës dhe atyre që jetonin në vise të tjera në Jugosllavi. Idriz Ajeti ishte referues kryesor. Mbledhja e 1952-s zgjodhi dhe autorizoi Komisionin prej 9 vetash, i cili do t'i shoshiste problemet e drejtshkrimit dhe kristalizonte qëndrimet rreth çështjeve të drejtshkrimit që u botuan në Shqipëri një vit më parë. Pas punës dyditëshe Mbledhja aprovoi Rezolutën, ku mes tjerash thuhej: “... në gjuhën e shkrimit po përdoret një gegërishte e panjësuar si për kah trajtëfjala, ashtu edhe për kah drejtshkrimi; Në tekstet e ndryshme shkollore e në botimet e tjera, sidomos në përkthime po vihet re njëfarë zvetënimi i gjuhës shqipe në vijim të përsosjes së disa trajtave

dhe shprehjeve që nuk pajtohen me frymën dhe natyrën e kësaj gjuhe; Zhvillimi i gjuhës shqipe ndër shqiptarët e vendit tonë nuk po shkon paralel me zhvillimin e jetës shoqërore, ekonomiko-politike e kulturore të vendit (Jugosllavisë). Kështu po ndihet një vobektësi e fjalorit për shprehjen e rezultatit tone”. Në Rezolutë propozohet që bazë e gjuhës letrare të vihet gegërishtja e mesme dhe kërkohet që redaksitë e ndryshme (të radios e të shtypit) dhe entet kulturore të ishin në duar të ekspertëve të gjuhës që nuk do të lejonin largime nga norma e aprovuar. Në këtë Rezolutë bëhet fjalë edhe për rrugët që duheshin të ndiqeshin për ta pasuruar fjalorin e shqipes, por nuk flitej për nevojën e studimit të të folmeve të gegërishtes verilindore e më gjerë. Komisioni i Mbledhjes së 1952-s propozonte të mos përdroreshin kosovarizmat e tipit *jam shkue, po shkojka*, të përdorej vetëm futuri i tipit *do të shkoj*, duke lënë jashtë formën: *kam me shkue*, ndërsa u la në fuqi përdorimi i imperfektit sigmatik (punofsha) dhe i imperfektit asigmatik (punonja). U vendos për përdorimin e *ë*-së në pozicionin fundor, po u lanë edhe më tej pa *ë* fundore emrat e tipit liris, Shqipris etj. Për përemrat pronorë u lejua përdorimi i apostrofit (khs, t'im, tonë etj.) që shënonte burimin etimologjik të tyre. Në Mbledhjen e 1952-s kishte rryma të ndryshme: njëra synonte që së paku në drejtshkrim t'i ruante, sa të ishte e mundur, format e përbashkëta gjuhësore të të dy varianteve letrare të shqipes, ndërsa tjetra synonte që edhe më tej t'i mbante të qarta dallimet dialektore ndërmjet varianteve letrare të shqipes. Kjo mbledhje shënohet në historinë e gjuhës letrare si tubimi i parë i shqiptarëve që jetonin në Kosovë, në Maqedoni e në Mal të Zi, ku u trajtuan problemet e ortografisë shqipe në mënyrë kolektive e të organizuar, si dhe u propozuan kritere për pastërtinë e gjuhës dhe për pasurimin e fjalorit. (Shkumbin Munishi)

MBLEDHJA GJUHËSORE E VITIT 1957. Mbledhja e dytë e mbajtur në Prishtinë për çështjen e drejtshkrimit. U mbajt më 30 dhe 31 maj në vitin 1957. Morën pjesë profesorë, shkrimtarë e intelektualë nga të gjitha trevat ku jetonin shqiptarët etnikë në ish-Jugosllavi. Hapjen saj e ka bërë Kolë Shiroka, i cili kishte thënë se ishin mbledhur për të ndrequr gabimet e deriatëhershme në këtë fushë dhe jo të merrnin “vendime të preme”,

të bënë unifikimin e drejtshkrimit, por jo unifikimin e përgjithshëm. Ishte diskutuar rreth zanores *ë* dhe ishin marrë vendime të natyrës obligative dhe të tjera fakultative. Aty mbështetet sugjerimi për dallimin e supozuar midis gegnishtes së shqiptarëve në Jugosllavi, jo rrallë të quajtur “kosovarishte” dhe gegnishtes së përgjithshme që ishte projektuar më 1952. Mbledhja pati për qëllim të thjeshtohet sa të jetë e mundur ortografia e shqipes, por gjithnjë duke u kujdesur që të mos cenohet karakteri shkencor i saj. Në këtë Mbledhje gjejmë rregulla për çështje të ndryshme me pretendime sistematizimi. Fonetikë: theksi hundor; theksi i shkurtër; theksi i gjatë. Morfologji: fjalët me origjinë të huaj *i* apo *jad*; drejtshkrimi i disa trajtave të foljeve; zgjedhimi i foljeve *me ardhë* dhe *me dijtë* në prezentin e indikativit; drejtshkrimi i disa fjalëve me *ç* apo *sh*; kthimi i togut *tsh* në *ç*; drejtshkrimi i fjalëve të huaja me *t* apo me *th*; transkriptimi i emrave të huaj; drejtshkrimi i disa ndajfoljeve; parafjalëve dhe lidhëzave; përdorimi i pronorëve me *nyjë* dhe pa *nyjë*; përdorimi i fjalës gjithë me *nyjë* apo pa të; ambigjinita; *e*-ja dhe *u*-ja e paqëndrueshme; përdorimi i *ë*-së tek emrat, mbiemrat, përemrat, numërorët, foljet etj.; fjalët e prejardhura; shumësi i disa emrave të gjinisë femërore; ndarja e fjalëve në rrokje. Si rezultat, u botuan disa “Rekomandime të mbledhjes së gjuhëtarëve për caktimin e disa çashtjeve të ortografisë së gjuhës shqipe”. Sa i përket zgjedhjes së gjuhës ajo i referohej Mbledhjes së 1952-s. Kundër saj nuk munguan as kundërshtimet publike. Një ndër to është ai i Idriz Ajetit, i cili tregonte lëshimet që kishin të dhënat ortografike të Mbledhjes së 1957-s, duke treguar edhe rrugët që duheshin ndjekur për normëzimin më të suksesshëm të gjuhës letrare shqipe në Kosovë dhe në vise të tjera etnike shqiptare. Ai bënte vërejtje sidomos lidhur me përdorimin e zanores *ë*. Vendimet e Mbledhjes së vitit 1957 mund të vlerësohen si një kthim prapa, meqë po shtyhej përpara ajo që synohej të ishte gjuhë letrare e veçantë për shqiptarët e Jugosllavisë, apo gegërishte vetëm e shqiptarëve të RFPJ-së. (Shkumbin Munishi)

MBLEDHJA GJUHËSORE E VITIT 1963. Mbledhja e tretë dhe e fundit e mbajtur në Kosovë për çështje të gjuhës dhe të drejtshkrimit të shqipes, e njohur si Këshillim. Mbledhja i zhvilloi punimet e veta më 14-16 janar 1963.

Fjalën e hapjes e mbajti Kolë Shiroka, kryetar i Pleqësisë Krahinore për Arsim e Kulturë, sipas të cilit diskutimet do të jenë për ortografinë dhe çështje të tjera të gjuhës. Në këtë tubim morën pjesë përfaqësues të institucioneve kulturore, arsimore e shkencore të Kosovës dhe të viseve të Maqedonisë e të Malit të Zi, si: S. Hasani, Q. Deva, I. Ajeti, M. Krasniqi, P. Janura, R. Nesimi, H. Vokshi, V. Shita, A. Zajmi, M. Bardhi, Xh. Gega, M. Begolli, S. Imami, M. Peza, A. Rexha, R. Hoxha, M. Lutfiu, A. Çetta, J. Mita, H. Kaleshi, L. Mulaku, A. Kelmendi, H. Mekuli, S. Drini dhe H. Shala. Merrnin pjesë edhe përfaqësues të organeve republikane e federative të ish-Jugosllavisë që direkt përziheshin edhe në punë të gjuhës. Në ditën e parë të Këshillimit u zhvillua diskutimi për çështjen e gjuhës e të ortografisë së shqipes, kurse dy ditët e fundit u shqyrtuan parashtrimet e projektit të ortografisë së gjuhës shqipe. Kishte një distancim të përmbajtur në raport me zhvillimin e deriatëhershëm të gegërishtes letrare, por në të njëjtën kohë theksohej ruajtja e tri ndryshimeve themelore (rotacizmi, nazaliteti dhe diftongu -ue/-ua). Aktiviteti për hartimin e një ortografie të re dhe të plotë pati filluar që nga viti 1961, atëherë kur Komisioni për Gjuhë dhe Letërsi i Pleqësisë për Arsim e Kulturë i KAKM-së (shih) kishte caktuar një komision për të rishikuar dhe për të plotësuar ortografinë me këtë përbërje: Idriz Ajeti, Hasan Vokshi, Sulejman Drini, Mehdi Bardhi dhe Latif Mulaku. Grupi punues në fazën e parë u mor më tepër individualisht me problemet drejtshkrimore që do të shkoqiteshin në mbledhjen e përbashkët, ndërsa në fazën e dytë, për disa muaj, shqyrtoi çdo çështje të diskutueshme e të kontestueshme të ngelur. Komisioni kishte hartuar projektografinë, e cila ishte vënë në diskutim publik në Këshillimin e gjuhëtarëve më 1963. Projekti i ortografisë së re solli në disa pika dy mënyra shkrimi. Këto u diskutuan në mënyrë të shumanshme në Mbledhjen e janarit të 1963-s. Në këtë Mbledhje u ngritën edhe shumë çështje të tjera të drejtshkrimit. Kjo ndikoi që ortografia të zgjerohet e të plotësohet në shumë lëmenj, që më parë nuk qenë trajtuar fare. Për të pasur më shumë përfaqësim për shqiptarët e Maqedonisë e të Malit të Zi, Komisioni u zgjerua edhe me disa anëtarë të tjerë: P. Janura, M. Isaku, Xh. Gega dhe L. Lucaj. Komisioni i plotësuar, pas

përfundimit të Mbledhjes së tretë të 1963-s i analizoi problemet e shtruar në këtë tubim shkencor dhe një grup punues u angazhua ta përpilonte tekstin e drejtshkrimit të gjuhës shqipe që do të botohej në Prishtinë më 1964 në formë broshure si Ortografi e parë e plotë që doli pas Luftës II Botërore në Kosovë. Kjo Ortografi kishte një afrim të dukshëm me atë të Institutit të Shkencave të Tiranës të vitit 1956, duke ruajtur vetëm karakteristika themelore të gegërishtes letrare, e cila deri atëherë kishte bërë një evolucion të dukshëm drejt njësimi me toskërishten letrare. Kjo çonte drejt një përafrimi edhe më të madh të dy kryedialekteve të shqipes, rrjedhimisht drejt një ortografie të përbashkët. (Shkumbin Munishi)

MBRETËRIA DARDANE. Organizim shoqëror dhe politik dardan. U krijua në hapësirat midis lumenjve Brong (Moravë), Timacus, Axios (Vardar), Astibo dhe rrjedhës së epërme të Drinit. Nga shek. VIII shquhet fuqizimi i dardanëve, ndërsa gjatë shek. VI-IV u zhvillua faza paraurbane, me vendbanime kodrinore me akropole dhe varre luksoze tumulare të aristokracisë fisnore. Ekonomia mbështetej në bujqësi, blegtori, xehetari, prodhimet artizanale, përpunim të metaleve dhe tregti. Diferencimi shoqëror dhe zhvillimi ekonomik solli dhe krijimin e shtetit. Burimet antike përmendin mbretërit dardanë me termin grek "basileos" dhe atë latin "rex". Prezenca e mbretërisë dardane nuk është mohuar, por janë shprehur mendime se kjo mbretëri ishte një formacion mbifisnor dhe se nuk arriti kurrë të zhvillohej në një formacion shtetëror. Duke lënë mënjanë mendimet e veçuara, përfshirë dhe ndikimet politike, nuk mohohet ekzistimi i një shteti dardan falë studimeve më të thelluara, të prezencës së fazës paraurbane dardane (shek. VI-IV), historisë politike dardane nga shek. IV p.e.r., ushtrisë së organizuar në fallanga, prezencës së skllëvërve etj. (Edi Shukriu)

MBRETI MILUTIN (Stefan Uroshi II) (1282-1321). Mbret i Rashës. Posa e mori pushtetin, i shpalli luftë Perandorisë Bizantine. Ai pushtoi Shkupin, krahinën e Pollogut (në Maqedoninë Perëndimore) dhe tri qytete të tjera në lindje të Vardarit. Bizanti u kundërpërgjigj përmes ushtrive mercenare tartare, të cilat depërtuan deri në afërsi të Prizrenit dhe të Janjevës, por nuk shënuan ndonjë sukses (1283). Milutini

vazhdoi ekspeditat kundër Bizantit, duke pushtuar krahinat e Poreçës, të Kërçovës dhe të Dibrës (1284) dhe përkohësisht Durrësin (1296). Sipas paqes së arritur midis Bizantit dhe Rashës (1299), kësaj të fundit iu njohën territoret e pushtuara në veri të Ohrit e të Durrësit. Më 1308, rasanët arritën marrëveshje me anzhuinët e Napolit, me ç'rast i ndanë zonat e ndikimit në Arbëri. Më 1309 mori titullin "mbret i Arbërisë" (*rex Albaniae*) dhe pushtoi përkohësisht Durrësin dhe Arbrinë, bashkë me Krujën (1318), që ishin nën sovranitetin anzhuin. Kur u krijua një koalicion antiserb i fuqive katolike, një numër fisnikësh shqiptarë njoftuan papën e Romës se ishin gati "të ngrinin krye dhe të largonin zgjedhën e mbretit të Rashës" (1319). Ndërkohë, në veri, Milutini shënoi suksese ndaj bullgarëve, ndërsa pas vdekjes së të vëllait Dragutin (1316), pushtoi një pjesë të zotërimit të tij (Braniçevën deri në Danub). Në kohën e Milutinit u ndërtuan shumë manastire, ndërsa pas vdekjes së tij, shteti i Rashës u përfshi nga luftëra të brendshme për pushtet. (Qerim Dalipi)

MBROJTJA E HOTIT DHE E GRUDËS (1880). Vetorganizim i shqiptarëve në luftë për mbrojtjen e krahinave të Hotit, Grudës dhe Kelmendit kundër aneksimit nga Mali i Zi, pas Traktatit të Berlinit. Si çështje lindi pas dështimit të përpjekjeve të Fuqive të Mëdha dhe të Malit të Zi për aneksimin nga ky i fundit i krahinave shqiptare të Plavës dhe Gucisë, në zbatim të nenit numër 28 të Traktatit të Berlinit. Propozimin për zëvendësimin e tyre me krahinat e Hotit, të Grudës dhe disa fshatrave të Kelmendit e dha ambasadori italian në Stamboll, Leone Korti. Sipas tij, meqenëse këto territore, në masë të madhe, banohen nga shqiptarë katolikë, ata nuk do të kundërshtonin që të bëheshin pjesë e një shteti me besim të krishterë, megjithëse ortodoks. Po sipas tij, shqiptarët myslimanë që luftuan për mbrojtjen e Plavës dhe të Gucisë nuk do të sakrifikonin për të mbrojtur krahinat e banuara nga populli të një besimi tjetër. Më 12 prill 1880 u nënshkrua marrëveshja paraprake midis Portës dhe Malit të Zi, ndërsa më 18 prill përfaqësuesit e Fuqive të Mëdha në Stamboll nënshkruan një protokoll të veçantë me Perandorinë Osmane, në të cilin përshkruhej vija e re e kufirit midis Turqisë dhe Malit të Zi. Këtij të fundit i bashkoheshin krahinat shqiptare të Hotit dhe të Grudës. Komiteti Ndërkrahinor

i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit për Shkodrën e organizoi dhe e drejtoi luftën për mbrojtjen e këtyre territoreve. Më 11 prill 1880 ai formoi shtabin ushtarak për mbrojtjen e Hotit dhe të Grudës, të kryesuar nga Hodo bej Sokoli, ushtarak i karrierës. Më 19 prill u organizua një miting i madh në Shkodër kundër vendimit për dorëzimin e këtyre krahinave Malit të Zi dhe, që aty, qindra vullnetarë u nisën për në vijën e frontit. Luftimet kryesore u zhvilluan më 22 prill 1880, tek Ura e Rzhanicës dhe në breg të lumit Cem, në Helm. Forcat e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit numëronin rreth 8,000 vullnetarë, ndërsa ushtria e Malit të Zi kishte 10,000 vetë. Pasi la shumë të vrarë e të plagosur në fushën e betejës, ushtria malazeze u tërhoq. Në luftimet për mbrojtjen e Hotit dhe të Grudës u shquan prijësit Baca Kurti dhe Ismail Marku. Pas dështimit për t'i dorëzuar Malit të Zi Plavën dhe Gucinë dhe Hotin e Grudën, Anglia dhe Austro-Hungaria propozuan që Malit të Zi t'i jepej Ulqini me rrethinë. Më 26 qershor 1880 Fuqitë e Mëdha e miratuan këtë propozim. (Islam Lauka)

MBROJTJA E PLAVËS DHE E GUCISË (1879-1880). Vetorganizim i shqiptarëve në kuadër të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, në luftë për mbrojtjen e tokave shqiptare, pas Traktatit të Berlinit. Ngjarjes i parapriu aksioni i Gjakovës, ku më 6 shtator 1878 mbeti i vrarë general i turk Mehmet Ali Pashë Maxharri, i ngarkuar nga Porta e Lartë për dorëzimin e territoreve shqiptare Malit të Zi dhe Serbisë, në zbatim të Traktatit të Berlinit. Gjithashtu, kësaj lufte i parapriu një deklaratë e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në gusht të viti 1878, në të cilën theksohej se nuk mund të kishte caktim të kufirit me Malin e Zi pa pëlqimin e saj. I ndodhur përballë faktit që Perandoria Osmane po tregojte paaftësi për zbatimin e vendimeve të Kongresit të Berlinit, Mali i Zi vendosi që të vërë në përdorim fuqinë e tij ushtarake për aneksimin e Plavës dhe të Gucisë. Beteja e parë ishte ajo e Nokshiqit, e zhvilluar më 4 dhjetor 1879 midis forcave të Malit të Zi, me rreth 4,000 vetë, të komanduara nga Mark Milani, dhe atyre të Lidhjes së Prizrenit, me rreth 2,000 vullnetarë, të komanduara nga Ali Pashë Gucia, Sylejman Vokshi, Jakup Ferri, Man Avdia, Haxhi Zeka etj. Pas disa orë luftimesh, ushtria malazeze u tërhoq duke lënë rreth 300 të vrarë. Forcat shqiptare, gjithashtu, patën 300-400 të

vrarë dhe të plagosur. Në këtë betejë ra një ndër komandantët më të njohur shqiptarë, Jakup Ferri. Beteja e dytë u zhvillua në Pepaj, më 8 janar 1880. Pas luftimeve të ashpra mbetën të vrarë dy prej komandantëve të forcave shqiptare, Kurt Asllani dhe Nure Kurti. Ashtu si në Nokshiq, edhe në Pepaj, ushtria malazeze u detyrua të tërhiqet. Humbja e dytë ushtarake e detyroi Cetinën, si dhe Fuqitë e Mëdha që, në vend të Plavës dhe të Gucisë, të kërkojnë territore të tjera në zbatim të vendimeve të Kongresit të Berlinit. (Islam Lauka)

MBROJTJA E ULQINIT (1880). Përpjekje e forcave vullnetare të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit për të mos ia dorëzuar Ulqinin Malit të Zi. Pas dështimit për të zbatuar vendimet e



FLOTA ANGLEZE NË ULQIN MË 1880

Kongresit të Berlinit, për t'ia dorëzuar Malit të Zi Plavën dhe Gucinë dhe më pas Grudën dhe Hotin, Fuqitë e Mëdha morën vendim që Malit të Zi t'ia jepnin Ulqinin. Për këtë qëllim u angazhua vetë Porta e Lartë, e cila krahas luftanijeve angleze që u ankoruan pranë qytetit dërgoi Dervish Pashën kundër forcave vullnetare të Lidhjes së Prizrenit. Para pushtimit, treva e Ulqinit ndodhej nën kontrollin e forcave vullnetare të Lidhjes Shqiptare, që drejtoheshin nga shtabi ushtarak i formuar për mbrojtjen e Ulqinit. Në Ulqin genë vendosur 2,000 vullnetarë. Vullnetarët të tjerë arritën nga Tetova, Dibra, Kelmendi, Prizreni, Gjakova etj., dhe pritej që numri i tyre të arrinte në 4,000. Ndërkohë, presionet e Dervish Pashës ndaj Komitetit Ndërkrahinor të Lidhjes për Shkodrën, për ta detyruar të dorëzonte Ulqinin nuk dhanë rezultate. Trysnisë së Dervish Pashës nuk iu gjunjëzua as Komiteti i Lidhjes për Ulqinin. Për dorëzimin

e Ulqinit Mali të Zi u angazhuan edhe konsujt anglezë e austro-hungarezë në Shkodër. Më 22 tetor të vitit 1880, Dervish Pasha i dha urdhër ushtrisë turke të fillonte marshimin për Ulqin. Në ditën e parë ushtria turke u ndesh me forcat vullnetare të Kodra e Kuqe, afër fshatit Klezna. Në fillim forcat vullnetare bënë qëndresë, por superioriteti në armatim bëri që forcat vullnetare të zmbropsën. Në këto luftime u plagos komandanti i vullnetarëve, Isuf Sokoli, i cili nga plagët më vonë vdiq. Pasi u thye ushtria vullnetare shqiptare, forcat ushtarake osmane hynë në Ulqin më 23 nëntor 1880, të cilët pastaj më 26 nëntor ia dorëzuan ushtrisë malazeze. Më dorëzimin e Ulqinit mori fund kriza dyvjeçare e caktimit të kufijve veriorë, e cila kishte krijuar shqetësime të mëdha të diplomacive europiane. (Isa Bicaj)

MEDALJONI I PROBIT. Ekzemplar i rrallë numizmatik, i farkuar me rastin e triumfit të perandorit romak Probit ndaj gotëve në Panoni (278). U zbulua rastësisht në arealin e



Ulbianës antike në vitet 50 të shek. XX. Në avers gjendet perandori me kurorë dafine në kokë dhe veshje ushtarake, i shoqëruar në plan të dytë me Jupiterin. Dorën e djathtë e ka të ngritur deri në lartësi të mjekrës,

kurse në të majtën mban skeptrin. Në revers perandori gjendet i hipur në kalë, me veshje ushtarake dhe duke mbajtur një heshtë. Pas tij është hyjnesha Viktoria, e cila mban palmën në dorën e majtë dhe në të djathtë kurorën që ia vendos perandorit në kokë. Para perandorit ndodhet "tropeumi" i ngritur me armët e armikut të nënshtruar dhe dy gotët robër, me duar të lidhura prapa. U punua nga bronzi, me mjeshtri të hollë artistike, në atelienë e qytetit Siscia. (Fatmir Peja)

MEDIANA. Vendbanim antik afër Nishit dhe rezidencë perandorake. U ndërtua në shek. IV gjatë sundimit të perandorit Konstantini i Madh. Gërmimet arkeologjike dëshmuuan madhështinë e saj, duke nxjerrë në dritë objekte të shumta, në mesin e të cilave dallohet pallati perandorak. Në të duhet veçuar gjetja e shtatores së Hyjneshtës Dardane. Nga fundi i shek. IV pësoi dëmtime të mëdha nga një

zjarr i fuqishëm, ndërsa u shkatërrua tërësisht nga hunët në shek. V. U rindërtua shpejt, por jo në madhësinë e dikurshme. Në fillim të shek. VII, pas invazionit avaro-sllav, u braktis përfundimisht. (Arben Hajdari)

MEDIET E SHTYPURA NË GJUHËN SHQIPE NË MAQEDONI. Gazeta e parë në gjuhën shqipe në hapësirën e Maqedonisë së sotme ishte gazeta “Shkupi”. Fletorja e përjavshme kishte katër faqe, me tre kolona dhe me format të vogël. Botohej në shqip dhe turqisht dhe drejtohej nga Jashar Erebara. U botua në Shkup, nga 29 gushti 1911 deri më 30 dhjetor 1911, në 14 numra dhe vijoi të botohej edhe në vitin 1912. Gazeta botonte lajme, komente, korrespondenca, letra dhe shkrime publicistike. Ajo mbështeste idetë e Rilindjes Kombëtare. Gazeta kishte qëndrim të matur ndaj Turqisë dhe ishte kritike kundrejt politikave të shteteve ballkanike në raport me Shqipërinë. Autorët e shkrimeve zakonisht nënshkruheshin me pseudonime.

Gjatë Luftës së Dytë Botërore në Tetovë nisi të botohej e përjavshmeja “Zani i Sharrit”, numri i parë i së cilës doli më 5 tetor 1944. Themelues dhe redaktor i saj ishte kryetari i atëhershëm i komunës së Tetovës, Shaip Kamberi, i cili u vra më 1947 nga forcat komuniste së bashku me disa veprimtarë të tjerë shqiptarë. Gazeta dha kontribut për emancipimin kulturor dhe politik të shqiptarëve në Maqedoni, kurse qëllimi kryesor i saj ishte afirmimi i idesë për bashkim kombëtar.

Nga 4 prilli i vitit 1945 nisi të botohej në Shkup gazeta “Flaka e vllaznimit” (më vonë “Flaka e vëllazërimit” e pastaj “Flaka”), si “Organ i Frontit Nacional-Çlirimtar për shqiptarët e Maqedonisë”. Themelues i saj konsiderohet ministri i parë shqiptar në Qeverinë e Maqedonisë socialiste, dr. Nexhat Agolli, kurse drejtor dhe kryeredaktor ishte dr. Petro Janura. Në fillim ishte gazetë dyjavore (1945), pastaj javore (1958), pastaj u botua tri herë në javë (1977), kurse nga 1994 u bë e përditshme, deri kur u shua më 2003, pas privatizimit të saj. Ndërsa ndërmarrja botuese “Flaka” kishte revistat për fëmijë “Gëzimi” (1950) dhe “Fatosi” (1955) dhe revistën për art, shkencë dhe kulturë “Jehona” (1962). Gjithashtu ka botuar edhe qindra libra për fëmijë dhe të rritur. Botimet e “Flakës” shtypeshin në mijëra kopje.

Pas viteve ’90 të shekullit të kaluar, në sistemin pluralist në Maqedoni u botuan shumë gazeta e revista, shumica prej të cilave nuk arritën të mbijetonin. Gazeta e parë me investim privat në Maqedoni ishte “Fakti”, që filloi të botohej nga viti 1998. Shumica e gazetarëve më të njohur shqiptarë në Maqedoni dolën nga kjo gazetë. Gjatë periudhës së parë të pluralizmit politik u botuan edhe disa të përditshme, si: “Lobi ditor”, “Koha e re”, “Lajm”, “Shqip”, “Zhurnal”. Sot botohen vetëm “Lajm” dhe “Koha”.

Revista e parë e pavarur në gjuhën shqipe në Maqedoninë ishte “Dita”, e themeluar nga partia e parë shqiptare në kohën e pluralizmit, Partia për Prosperitet Demokratik. Më pas u botuan revistat “Tribuna Sh” (Shkup), “Globi” (Shkup), “Koha” (Shkup), “Epoka” (Tetovë), “Lobi” (Shkup), “Nacional” (Tetovë). Sot nuk botohet asnjëra prej tyre. Aktualisht botohet periodikisht revista fetare “Hëna e re” (Shkup), si organ i Bashkësisë Islame në Maqedoni dhe revista mujore sociokullore e politike “Shenja” (Shkup). Pas viteve ’90 u botuan edhe disa revista kulturore: “Vlera”, “Brezi 9”, “Stili”, “Edukimi qytetar”, “Jehona e re”, “Alternativa”, “Pro kultura”, “Cogito”, “Plejada” etj., si dhe disa revista për fëmijë: “Xixëllima”, “Ylberi”, “Nxënësi”, “Alba” etj. Gjithashtu u botuan edhe disa revista shkencore, kryesisht si botime institutesh të ndryshme apo të Universitetit të Tetovës dhe Universitetit të Europës Juglindore në Tetovë, si: “Universitas”, “Vizioni”, “Shqyrtime Albanologjike”, “Filologjia”, “Albanologjia”, “Diskutime”, “Filozofia”, që botohen periodikisht.

Pas viteve ’90 në Maqedoni u botuan edhe disa gazeta e revista dygjuhëshe, shqip dhe maqedonisht, të cilat nuk arritën të mbijetonin, siç ishin: “Global”, “Gostivar Voice”, “Point”, “Kërkimi i terrenit të përbashkët” etj. (Selajdin Salihu)

MEDIET E SHTYPURA NË KOSOVË. Zhvillimi i vonuar i gazetarisë së shtypit në Kosovë u kushtëzua nga sistemi kolonizues i Perandorisë Osmane, ndërsa pas vitit 1912 edhe i Mbretërisë së Serbisë dhe i Jugosllavisë. Për këtë arsye botime të para fletushkash të përkohshme në gjuhën shqipe gjenden mbas viti 1941, kur gjuha shqipe në Kosovë bëhet gjuhë e administratës dhe e arsimit publik. Gjatë viteve 1941-1944 u botuan gazetat “Kosova” dhe “Lidhja e Prizrenit”, që të dyja

të afërta me pushtetin e kohës, përkatësisht me qeverinë e Tiranës dhe Lidhjen e Dytë të Prizrenit. Në këtë periudhë dilnin edhe disa broshura komuniste si “Zani i popullit” dhe “Lirija” me përmbajtje propagandistike. Ndërkaq, gazetaria institucionale nis me gazetën “Rilindja”, numri i parë i së cilës u botua më 12 shkurt 1945, në katër faqe me tirazh 1,000 kopje. “Rilindja” filloi punën me një redaktor dhe tre gazetarë. Nga viti 1948 deri më 1957 kjo gazetë e vetme në gjuhën shqipe botohet dy herë në javë, ndërsa nga nëntori i vitit 1958 del si e përditshme. Po më 1945 nis të botohet fletushka për rini, “Zani i rinisë”, pastaj nga viti 1946 fletushka për fëmijë “Pionieri”, revista për letërsi “Jeta e re”, ndërsa “Shëndeti” nga viti 1953.

Në vitet '70 të shekullit XX, me zgjerimin e autonomisë së Kosovës, edhe shtypi përjeton zhvillim më të përshpejtuar. Krahas gazetës “Rilindja” në gjuhën shqipe, “Jedinstvo” në gjuhën serbe dhe “Tan” në gjuhën turke, nis botimi i revistës për kulturë dhe art “Fjala”, për arsim “Shkëndija”, për bujqësi “Bujku”, për humor “Thumbi”, për gra “Kosovarja”, të gjitha këto në kuadër të Ndërmarrjes Gazetare Botuese Grafike (NGBG) “Rilindja”. Botohet edhe gazeta e studentëve të Universitetit të Prishtinës, “Bota e re”, e cila u themelua në vitin 1968. Kështu, në vitin 1985 në Kosovë botoheshin 42 revista javore, 3 njëmuajore, 5 dymujore dhe 2 tremujore. Në këtë periudhë dilnin gjithsej 55 gazeta, por prej tyre vetëm 2 ishin të përditshme, “Rilindja” në gjuhën shqipe dhe “Jedinstvo” në gjuhën serbokroate, ndërsa gazeta “Tan”, që botohej në gjuhën turke, ishte javore. Një numër i madh i gazetave botoheshin nga ndërmarrjet ekonomike, si “Kosova” e Obiliqit, “Trepça” e Mitrovicës etj. Botoheshin edhe gazeta politike, të cilat propagandonin ideologjinë e komunizmit jugosllav dhe njëra nga këto ishte “Komunisti”, e cila kishte një botim të veçantë për Kosovën, në gjuhën shqipe dhe serbokroate.

Në vitin 1983 shitja ditore e gazetës “Rilindja” arrinte gjithsej 20,895 kopje, ndërsa një vit më vonë kjo gazetë arriti tirazhin ditor prej 48,768 copë. Ndërsa gazeta tjetër ditore serbe “Jedinstvo” shitej në 5,252 kopje. Ishte kjo periudhë, kur Kosova ishte futur në një proces dinamik të zhvillimeve politike. Gjatë kësaj periudhe gazeta “Rilindja” dominohej nga përmbajtjet informative: sillte shumë lajme

dhe raporte çfarë ndodhte në Kosovë, në Universitetin e Prishtinës, në forumet politike, në institucione, në kulturë etj. Në vitin 1990, “Rilindja” u lirua plotësisht nga censura dhe u vu hapur në shërbim të interesit të lexuesit. Por kjo situatë nuk zgjati. Më 5 korrik 1990, mbi 100 policë të armatosur rrethuan Pallatin e Shtypit, ku ishte selia e “Rilindjes”, duke bërë presion dhe duke keqtrajtuar gazetarët e punonjësit shqiptarë. Më 7 gusht 1990, Kuvendi i Serbisë mori vendimin për ndaljen e botimit të gazetës “Rilindja”, duke bërë që shqiptarët të mbesin edhe pa mediet e tyre të shkruara. Në këtë kohë nga puna u larguan rreth 1,600 punëtorë të “Rilindjes”. Ndërhyrja e dhunshme u shoqërua edhe me demolimin e hapësirave të punës dhe njëherësh u plaçkitën pjesa dërrmuese e pajisjeve të punës. Në maj të vitit 1993 regjimi serb shoi tërësisht xhirollogaritë e “Rilindjes” dhe të revistës së përjavshme “Zëri”, duke ua marrë këtyre subjekteve të gjitha pasuritë që kishin krijuar gjatë 50 viteve të veprimtarisë. Gazetarë, redaktorë dhe punonjës të medieëve shqipe u hodhën në grevë urie në mbrojtje të shprehjes dhe publikimit të fjalës së lirë. Greva njëmbëdhjetëditëshe nuk solli ndonjë rezultat, për të ndryshuar vendimin arbitrar të Serbisë. Gazeta “Bujku”, që u shfaq si alternativë e “Rilindjes” së ndaluar dhe revista “Zëri”, që ishte vazhdimësi e revistës “Zëri i rinisë” u detyruan të paguanin qira për qëndrimin në objektet e veta. Revistat që dilnin në kuadër të NGBG “Rilindja” deri në këtë kohë, për shkak të qirasë së lartë, u detyruan ta braktisnin Pallatin e Shtypit.

Gjatë viteve '90, në rrethanat e krijuara të dhunës që ushtrohej mbi të gjitha segmentet e jetës në Kosovë, mediet e shtypura u përpoqën të mbijetonin, duke zhvilluar veprimtari paralele dhe duke iu përgjigjur interesave të lexuesve. Përveç gazetës “Bujku”, në treg u shfaqën edhe një sërë revistash të reja, ose që ishin vazhdimësi e revistave të mëhershme, si “Zëri”, “Kosovarja”, “Shkëndija”, “Thumbi” etj. Një kohë dolën revistat javore politike “Ora” dhe “Koha”. Ndërkaq, në këtë periudhë një pjesë e aktivitetit politik të shqiptarëve të Kosovës u zhvendos në diasporë. Përveç gazetës “Zëri i Kosovës”, në Perëndim filluan të nxirrnin botimet e tyre edhe “Rilindja”, “Zëri”, “Kosovarja”, “Bota e re”, ndërsa u shfaqën edhe gazeta dhe revista të reja, të cilat shfrytëzonin tregun e Perëndimit për të mbijetuar në Kosovë.

Ndërkohë, më 3 prill 1997 doli numri i parë i gazetës “Koha ditore”, e cila nga 10 marsi 1997 filloi të dilte çdo ditë. Më 12 shtator 1998 filloi botimin gazeta tjetër ditore, “Kosova sot”. Më 18 mars 1999 gazeta “Kosova sot” u dënua nga gjykatat serbe në Kosovë me një shumë prej 300 mijë markash gjermane, që e detyroi të pushojë botimin. Gjatë periudhës së bombardimeve të NATO-s mbi caqet serbe në Kosovë, të gjitha mediet e shtypura e ndalën botimin. Mbas qershorit të vitit 1999, në Kosovë nisnin të botohen gazeta dhe revista të shumta, nga të cilat shumica syresh nuk arritën të mbijetonin për një kohë të gjatë, si: “Koha ditore”, “Zëri”, “Epoka e re”, “Bota sot”, “Dardania”, “Dita”, “Gazeta shqiptare”, “Lajm”, “Infopress”, “Gazeta express”, “Illyria” dhe revistat: “Ekskluzive”, “Interesi Nacional”, “Teuta”, “Java” etj. (Ibrahim Berisha.)

MEDIET ELEKTRONIKE NË KOSOVË. Historia e medias elektronike në Kosovë fillon në vitin 1927. Sinjali i parë elektromagnetik u transmetua nga Mitrovica, me mbështetjen



RADIO-KOSOVA

e kompanisë angleze “Selection Trust Ltd.”, e cila menaxhonte minierën “Trepça”. Programet e para ishin me përmbajtje informuese për minatorët dhe punonjësit e “Trepçës”, por njëkohësisht emetoheshin edhe pika muzikore. Nga fundi i vitit 1941 nis emetimi i programit radiofonik edhe nga Prizreni. Radio-Prizreni kishte fuqi transmetuese prej 200 vat. Programi

kryesisht transmetohej në gjuhën shqipe dhe herë mbas herë edhe në atë turke. Nxënësit e gjimnazit real “Sami Frashëri” në Prishtinë zgjeruan rrjetin radiodifuziv në vitin 1942 me radiostacionin që u quajt Radio Kosova dhe që kishte kapacitet transmetues prej 500 vat. Transmetimi i parë i drejtpërdrejtë në radio në gjuhën shqipe u bë më 28 nëntor 1943 në Prishtinë, kur u përcoll kremtimi i Ditës së Flamurit. Këtë transmetim e organizoi profesori Bedri Gjina. Pas Luftës së Dytë Botërore, në nëntor të vitit 1944 filloi punën në Prizren radioja që kishte synim themelor propagandën komuniste jugosllave. Më 5 shkurt 1945 transmetohet program i rregullt nga Radio-Prizreni, në gjuhën shqipe dhe serbokroate. Radioja më pas transferohet në Prishtinë, me çrast ndërron dhe emrin në Radio Prishtina. Në vitet '60, Radio Prishtina transmetonte 70% të programit në gjuhën shqipe, 17% në atë serbokroate dhe 8% në gjuhën turke. Fuqia e saj transmetuese ishte 100 kilovatë.

Programet e para televizive në Kosovë shihen nga viti 1959. Repetitori i parë instalohet në gusht të vitit 1963, në Fushën e Gjanë (Veternik), në periferinë jugore të Prishtinës. Ndërkohë, edhe rrjeti i radiove lokale u zgjerua mbas fillimit të punës së radiostacioneve rajonale, që ishin pjesë e Radio Prishtinës. Televizioni i Prishtinës (TVP), ndërkaq, fillon emetimin e programit nga nëntori i vitit 1975, në fillim me tri orë program në ditë. Themelues i Radiotelevizionit të Prishtinës (RTP) ishte Kuvendi i Kosovës. Kosova kishte pavarësi të kufizuar politike-administrative, mbështetur në Kushtetutën që u nxor më 1974. Sfera e informimit kishte status të përafërt që e kishin edhe mediet e tjera në ish-Jugosllavi. Puna e medias elektronike rregullohej me dy ligje të veçanta: “Ligji mbi mjetet e informimit publik” dhe “Ligji mbi RTP-në”. Nga reklamat dhe programet propaganduese siguroheshin 25-35% të të ardhurave, ndërsa 65-75 për qind të mjeteve financiare siguroheshin nga buxheti i Kosovës. RTP-ja në vitin 1984 emetonte 48% program origjinal, ndërsa 71% e audiencës ishte shqiptare.

Më 5 korrik 1990, tri ditë pas miratimit të Deklaratës së Pavarësisë, RTP-ja u pushtua nga forca të mëdha të policisë serbe, të cilat hynë dhunshëm në lokalet e RTP-së dhe në orën 15:17 ndërprenë emisionin e lajmeve. Regjimi serb instaloi administratën e dhunshme

në këtë institucion, duke nxjerrë nga puna gazetarët dhe punëtorët shqiptarë. Kështu filloi periudha e errët e medias në gjuhën shqipe, veçmas e medias elektronike, për shkak të infrastrukturës së transmetuesve të kontrolluar nga shteti i dhunshëm serb. Media multietnike RTP në periudhën 1990-1999 shndërrohet në medie të regjimit të Millosheviqit, duke edituar program vetëm në gjuhën serbe, me përmbajtje luftënxitëse, fyese dhe denigruese për shqiptarët.

Ndërkohë, u bënë përpjekje për programe alternative të medias elektronike. Radio "Koha" nisi më 1998 një emision 15 minutash të lajmeve përmes internetit, por ky program eksperimental u shua shpejt. Po në këtë kohë fillon transmetimin përmes internetit edhe i Radios 21, por fillimi i luftës e detyroi ndërprerjen e emetimit nga Prishtina. Më 4 janar 1999, në orën 15:55, nga një radiostacion në malet e Berishës në Drenicë, Radio "Kosova e lirë" bën transmetimin e parë eksperimental 5 minutash. Radio "Kosova e lirë" gjatë luftës ishte transmetuese informative nga terrenet e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Pas luftës, më 19 shtator 1999, pas një marrëveshjeje mirëkuptimi ndërmjet Unionit Europian të Transmetuesve (EBU) dhe Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim Europian (OSBE) fillon punën Radiotelevizioni i Kosovës (RTK), duke transmetuar program që zgjaste dy orë. Tre muaj më vonë programi zgjerohet edhe për dy orë me emisione lajmesh edhe në gjuhën serbe dhe turke. Transmetimi i programit 24 orë nis më 22 dhjetor 2003. Kontrolli kryesor profesional dhe redaksional, përfshirë edhe përzgjedhjen e kuadrit, ushtrohej kryesisht nga administrata ndërkombëtare. Në kuadër të RTK-së ishin edhe transmetuesit radiofonikë: Radio Kosova dhe Radio "Blue Sky". Vendimi nr. 2001/13, nënshkruar nga Përfaqësuesi Special Ndërkombëtar, Hans Hakerup konstitui Radiotelevizionin e Kosovës si shërbim i transmetimeve publike të Kosovës. Radiotelevizioni i Kosovës nuk është vazhdim i institucionit të mëhershëm i Radiotelevizionit të Prishtinës. Ligji i RTK-së u miratua nga Kuvendi i Kosovës më 20 janar 2006. Nga viti 2007, RTK-ja transmeton program në gjuhën shqipe dhe njëherësh edhe në katër gjuhë të minoriteteve: serbe, boshnjake, turke dhe rome.

Mbas vitit 1999 në Kosovë kishte një ekspansion të medias elektronike. Pluraliteti politik

dhe pronësor nxit hapjen e medieve elektronike dhe të shtypit. Krahas transmetuesit publik, RTK-së, u zhvilluan edhe mediet private nacionale elektronike: RTV 21, Koha Vision dhe Radio-Dukagjini. Në fund të vitit 2001 në Kosovë ishin të paraqitura e të licencuara për punë 48 radio në gjuhën shqipe, 22 radio në gjuhën serbe, nga 2 radio në gjuhën turke dhe boshnjake dhe tri radio në gjuhën rome. Një numër mediesh elektronike u krijuan me financime donatorësh ndërkombëtarë. Ndërkohë, transmetimi i programeve të medieve të Kosovës është shtrirë edhe në sistemin kabllor dhe digjital, duke mundësuar rritjen e audiencës jo vetëm në Kosovë, por edhe jashtë. Edhe numri i transmetuesve lokalë është rritur ndjeshëm, përfshirë edhe një numër televizionesh të Shqipërisë, të cilët shfrytëzojnë rrjetet kabllor për të zgjeruar audiencën e tyre edhe në Kosovë. Politika që u zbatua nga shqiptarët dhe ndërkombëtarët mbas 12 qershorit të vitit 1999 ishte një shmangie nga arbitrariteti dhe u adaptuan politika të ndërtimit të medias së paqes. (Ibrahim Berisha)

MEDIET TRANSMETUESE SHQIPE NË MAQEDONI. Medie e parë transmetuese në gjuhën shqipe në Maqedoni është Radio-Shkupi (më vonë Radio-Maqedonase), e cila filloi të jepte program nga 28 dhjetori i vitit 1944. Transmetimi i parë ishte Mbledhja e Dytë e KAÇKJ-së, kurse Televizioni Maqedonas (më herët Televizioni i Shkupit) nisi të transmetonte program nga 14 dhjetori i vitit 1964. Radioja maqedonase jep program në të gjitha gjuhët e bashkësive etnike: në gjuhën shqipe (prej vitit 1948), në gjuhën turke (1945), në gjuhën vllahë (1991), në gjuhën rome (1991), në gjuhën serbe (2003) dhe në gjuhën boshnjake (2003), ndërsa jep emisione për dëgjuesit jashtë atdheut edhe në gjuhën bullgare, greke, shqipe (1971) dhe në gjuhën serbe (prej vitit 1999).

Në kanalin e dytë të Televizionit Maqedonas (MTV) jepet program për bashkësitë joshumicë: në gjuhën shqipe, turke, serbe, rome, vllahë dhe boshnjake. Kanali i tretë transmeton aktivitetet e Kuvendit të Maqedonisë në maqedonisht dhe shqip. Deri në muajin gusht të vitit 2002, programi në gjuhën shqipe transmetohej në kanalin e tretë të MTV-së, në dy orë e gjysmë, kurse më pas me 9 orë në programin e dytë.

Pas viteve '90 të shekullit të kaluar, në Maqedoni u themeluan shumë radio e televizione lokale,

me pronësi private, disa prej të cilave u shuan shpejt, kurse disa arritën të mbijetonin. Program kanë emetuar radiot “Visari”, “Bleta”, “Fama”, “Kanali 21” në Tetovë, “Vat” në Shkup, “Zëri i Çegranit”, në Gostivar, “Art Kanal” dhe “Kaltrina” në Strugë, “Uskana” në Kërçovë, “Hana” dhe “Albana” në Kumanovë, “Semi” në Dibër; televizionet lokale: “Super skaj”, “Art”, “Koha”, në Tetovë, “Era” në Shkup, “Kaltërina” në Strugë etj. Së fundi, në Maqedoni janë pesë televizione kombëtare që japin program në gjuhën shqipe: Televizioni Publik MTV, “Alsat-M”, “Shenja”, “TV-21” dhe “Art”, kurse televizioni kombëtar “TV-Alb” u shua pas disa muaj transmetimi. Në Maqedoni funksionojnë edhe një numër portalesh në gjuhën shqipe, disa prej të cilave me karakter informues. Edhe Agjencia Informative Maqedonase (MIA) ka edicionin e saj në gjuhën shqipe. (Salajdin Salihu)

MEDRESEJA “ISA BEU”, SHKUP. U hap më 1984, në fshatin Kondovë të Shkupit. Shkolla vazhdon traditën e medresesë së hershme, themeluar nga Isa Beu në vitin 1469, e cila punoi pa ndërprerje për më shumë se dy shekuj, pastaj u rihap në vitin 1936 dhe sërish u mbyll më 1941. Medreseja ka statusin e shkollës së mesme profesionale katërvjeçare. Programi mësimor i lëndëve fetare është i njëjtë me programet e medreseve në Kosovë, Shqipëri, Bosnjë e Hercegovinë etj., kurse programi i lëndëve shoqërore është i njëjtë me atë të shkollave të mesme të arsimit të përgjithshëm, të aprovuar nga Ministria e Arsimit e Maqedonisë. Vep-rintaria e saj financohet nga Bashkësia Islame e Maqedonisë. Viteve të fundit janë hapur edhe degë të kësaj medreseje për vajza në Tetovë, në Shkup dhe në Gostivar. Më 2005 u hap paralelja e Shtipit (për djem). Disa nga nxënësit e medresesë fituan tituj të lartë shkencorë ose mbajnë poste me rëndësi në institucionet e Maqedonisë. (Elez Ismaili)

MEDRESEJA “PIRINAZ” E PRISHTINËS. Ndër medresetë më aktive në Kosovë gjatë gjysmës së dytë të shek. XIX dhe në gjysmën e parë të xhek. XX. Gjendej në oborrin e xhamisë me të njëjtin emër. Nuk dihet se kur u ndërtua medreseja, por mendohet se nisi punën nga mesi i shek. XIX. Ndryshe quhej edhe Medreseja e Re. Edhe pse medreseja ishte e ndarë si godinë nga xhamia dhe tyrbja, ajo

përbënte një kompleks unik. Në këtë medrese dhanë mësim Mehmet Sezai, kurse më vonë Faik Rashid Maloku, Hysen Statovci, Hamdi Ibrahim Gërçina dhe Ahmet Mardoçi. Në medrese i ndoqën mësimet një numër të madh i të rinjve nga Prishtina dhe trevat përreth. Medreseja e “Pirinazit” veproi deri më 1927, kur u mbyll me pretext se po përgatiste ithtarë të Komitetit për Mbrojtjen e Kosovës. Pas kësaj u hap përsëri dhe punoi deri në vitin 1948, kur u mbyll përfundimisht. (Sadik Mehmeti)

MEDRESEJA ATIK, GJILAN. Veproi nga gjysma e shekullit XIX, deri në përfundimin e Luftës së Dytë Botërore (1944), u hap sërish më 1992, si paralele e Medresesë “Alaudin” të Prishtinës. Medreseja më parë zhvilloi aktivitetin afër Xhamisë së vjetër (Atik). Medreseja ishte e tipit konviktor, kishte edhe një bibliotekë të pasur librash, nga e cila nuk është ruajtur asnjë gjurmë. Medreseja kishte tri klasë me rreth 60 nxënës, me nga dy mësimdhënës. Si mësimdhënës dhanë kontributin e tyre emra të njohur të jetës fetare të qytetit të Gjilanit, si myderriz Haki efendi Sermaxhaj etj. Në raportet e Ylema Mexhlisit të Shkupit për vitin 1938/39 Medreseja e Gjilanit u cilësua ndër më aktivet në Kosovë. (Aliriza Selmani)

MEDRESEJA E BESHARET BEUT, PRISHTINË. Nisi punën që para vitit 1566. Në vitin 1582 u dëshmuua se në këtë medrese kanë dhënë mësim dijetarët e shquar të kohës, si: Mehmet Çelebiu, Husamudin “Levhi”, Ibrahim Efendiu, Abdullah Efendiu, Abdylkadir Efendiu etj. Myderrizi i kësaj medreseje, Ali efendi Haskojliu, në vitin 1719, për bibliotekën e kësaj medreseje ka lënë vakëf një dorëshkrim që aktualisht ruhet në Arkivin e Kosovës. Medreseja punoi deri në vitin 1912, kurse me ndërprerje deri në vitin 1948, kur u mbyll përfundimisht. Në këtë medrese ka dhënë mësim edhe bibliofili dhe poeti Hysejn Haxhi Sadiku, myderrizi i njohur Nazif Efendiu nga Prishtina etj. Myderriz i fundit ka qenë Haxhi Iljas Shasivari. (Sadik Mehmeti)

MEDRESEJA E EMIN PASHË RROTLLËS, PRIZREN. E ndërtoi Emin Pashë Rrotlla, mytesarif i sanxhakut të Prizrenit gjatë viteve 1841-1842, i biri i Tahir Pashës. U themelua në vitin 1831, por ndërtimi i saj përfundoi në vitin 1855, pas vdekjes së donatorit të saj. Myderriz

i parë i kësaj medreseje ishte historiani, epigrafisti dhe poeti i njohur Mehmet Tahir efendiu. Pas vdekjes së myderriz Tahir Pashës, në këtë post u emërua djali i tij, Mehmet Emin efendiu, myfti i Prizrenit, kaligrafist dhe autor i disa veprave në dorëshkrim. Medreseja gjendej në oborr të xhamisë me të njëjtin emër dhe funksionoi pa ndërprerje deri në vitin 1912. Pas pushtimit serb, medreseja funksionoi me ndërprerje vetëm disa vjet. Kompleksi i saj përbëhej nga disa objekte dhe ishte e tipit konviktor. Në të vijuan mësimin një numër i madh i nxënësve nga Prizreni, nga rrethina dhe nga kazaja e Lumës. (Sadik Mehmeti)

MEDRESEJA E GAZI ALI BEUT, VU-SHTRRI. Këtë medrese së bashku me një xhami në Çarshi dhe objekte të tjera i ka ndërtuar Gazi Ali beu në gjysmën e parë të shek. XV. Në Arkivin e Kosovës ruhet një diplomë e vitit 1885, e cila dëshmon për punën e kësaj medreseje dhe myderrizin e saj. Diploma është e Haxhi Mustafës, të cilën i lëshoi myderrizi Haxhi Ahmet efendiu nga Vushtrria. Në këtë medrese dhanë mësim edhe Abdylkadër dhe Selim "Sami" Drejta. Medreseja kishte mësonjëtorën dhe gjashtë dhoma të ndërtuara brenda oborrit. Medreseja punoi deri në vitin 1948, kur edhe u mbyll përfundimisht. (Sadik Mehmeti)

MEDRESEJA E GAZI MEHMET PASHËS, PRIZREN. Është ndër medresetë më të vjetra në Kosovë, të cilën e ndërtoi Gazi Mehmet Pashë Jahjapasha në vitin 1537. Njihet ndryshe edhe si Medreseja e Bajraklisë. Në këtë medrese kanë dhënë mësim emra të njohur të jetës publike dhe arsimore të Prizrenit dhe më gjerë, si Hafiz Sylejman efendiu, i biri i tij dhe kryetari i Lidhjes së Prizrenit, Haxhi Ymer Prizreni, Ibrahim Elbasani, Abdylhalim Gjergjizi, Hafiz Rrystem Shporta, Haxhi Ymer Lufti Paçarizi, Abdullah Durmishi, Ali Riza efendiu, Haxhi Musa efendiu, Qamil Mehmeti, Hasan Nahi etj. Medreseja luajti rol të rëndësishëm edhe në jetën kulturore-arsimore të popullatës së Kosovës dhe Shqipërisë Verilindore. Aty u përgatitën kadro për klerikë, edukatorë dhe nëpunës. Një numër i madh i tyre u dëshmuar edhe si atdhetarë të shquar, kurse disa syresh u bënë edhe dijetarë të njohur. Në periudhën e fundit të veprimtarisë së saj (1878-1948), medreseja luajti edhe rolin e një klubi kulturor

shqiptar. Në godinat e kësaj medreseje u themelua Lidhja Shqiptare e Prizrenit dhe më pas të gjitha objektet e kompleksit të saj iu lanë në dispozicion Lidhjes së Prizrenit. Nga ish-medreseja sot ruhet der' shanja (sot: Shtëpia Muze e Lidhjes), e cila u dogj më 1999 nga forcat serbe, por u restaurua po atë vit. Ruhen po ashtu edhe nga gjashtë dhoma në të dy katet, të cilat lidhen me korridore të ngushta dhe secila ka dy-tri dritare të mëdha të mbuluara me arkitra. Medreseja, me disa ndërprerje të vogla, punoi deri në vitin 1948, kur u mbyll përfundimisht. (Sadik Mehmeti)

MEDRESEJA E JAVUZ MEHMET EFENDIUT, PRIZREN. Meqë ndodhej përballë Xhamisë së Sofi Sinan-Pashës, njihet edhe si Medreseja e Sinan Pashës. E ndërtoi ish-anëtari i Këshillit të Lartë të sanxhakut të Prizrenit, Javuz Mehmet efendiu, i cili vakëfnamenë e vet e legalizoi në vitin 1867, kur e zyrtarizoi edhe medresenë. Për mirëmbajtjen e kësaj medreseje, ndërtuesi la vakëf tri dyqane të terzinjve. Myderriz i parë i kësaj medreseje qe emëruar Abdylhalim Efendiu dhe pas tij, në periudhën 1908-1912, në këtë postë emërohen Nuri Efendiu dhe më vonë Mustafa Tevfik efendiu. Funksionoi deri në vitin 1920. Mësimet në të i ka ndjekur një numër i madh i nxënësve nga kazaja e Prizrenit, Opojës, Gorës dhe Lumës. Një pjesë e ndërtesës së medresesë edhe sot është në gjendje funksionale. Ndërtesa ka arkitekturë karakteristike dhe bashkë me xhaminë e Sofi Sinan Pashës bëjnë pjesë në objektet më të vjetra të arkitekturës osmane në Sheshin e Shatërvanit në Prizren. (Sadik Mehmeti)

MEDRESEJA E MADHE E GJAKOVËS. U ndërtua në vitin 1707 nga Murad Beu (pasha) i derës së Kryezinjve. Një numër dorëshkrimesh të bibliotekës së kësaj medreseje janë të kopjuara nga vetë Murad Beu, ndërsa shumë dorëshkrime të tjera i ka blerë dhe ia ka dhuruar medresesë së tij. Myderrizë të parë të kësaj medreseje ishin Ali Pera nga Gjakova dhe Vejsel Efendiu nga Shkodra dhe më pas: Ismail Efendiu, Iljaz Efendiu, Fahri Efendiu etj. Këtu ka dhënë mësim edhe myderrizi i shquar dhe myftiu i Gjakovës, anëtari i Lidhjes së Prizrenit, Hasan Shllaku, pastaj Islam Nuredini Nahi, Jahja Efendiu, Seid Efendiu, Tahir Brovina, Hasan Nahi etj. Për shkak të renomesë që kishte, në medrese vinin nxënës nga shumë

anë të Kosovës, sidomos nga kazaja e Gjakovës dhe e Pejës, po edhe nga Sanxhaku. Kjo shkollë punonte sipas programit të Fakultetit Teologjik “Fātih” të Stambollit dhe kishte një konvikt të madh dhe një bibliotekë të pasur. Punoi deri në vitin 1948, kur edhe u mbyll, si të gjitha medresetë në Kosovë. (Sadik Mehmeti)

MEDRESEJA E MAHMUT PASHË RROTLLËS, PRIZREN. E ndërtoi Mahmut Pashë Rrotlla ndërmjet viteve 1806-1831. Gjendej në lagjen Bylbyldere. Mahmut Pashë Rrotlla në afërsi të konakëve të veta, ndërtoi xhaminë, mejtepin dhe medresenë me mësonjëtorë me tetë dhoma për vendosjen e nxënësve. Për mirëmbajtjen e këtyre objekteve dhe për rrogat e myderrizëve, si dhe për shpenzimet rreth ushqimit dhe nevojat e tjera të nxënësve i la vakëf katër dyqane, mullirin me pesë gurë dhe 15,000 akçe para të gatshme. Medreseja zhvilloi veprimtarinë e saj deri në vitet njëzet të shek. XX. Në të dhanë mësimet myderrizë të njohur. Objektet e saj nuk janë ruajtur. (Sadik Mehmeti)

MEDRESEJA E MESME “ALAUDIN” E PRISHTINËS. Shkollë e mesme fetare me seli në Prishtinë. Deri në vitin 1948, kur mbyllet medreseja e fundit në Kosovë, kanë ekzistuar



MEDRESEJA “ALAUDDIN”, PRISHTINË

një numër i konsiderueshëm i medreseve. Medreseja “Alaudin” u themelua në Prishtinë më 1951, si Medrese e Ulët. Punën si institucion arsimor e nisi në një objekt në oborrin e Xhamisë “Alaudin”, prej nga më vonë e mori edhe emrin. Si Medrese e Ulët veproi deri në vitin shkollor 1962/63, kur ngrihet në rangun e Medresesë së Mesme me sistem mësimi 5-vjeçar. Ndërkaq, në vitin 1983 u bë ndryshimi i plan-programit

mësimor dhe medreseja nga 5-vjeçare u bë katërvjeçare, si të gjitha shkollat e tjera të mësuessisë. Medreseja “Alaudin” e Prishtinës deri vonë mbeti e vetmja shkollë e tillë në të gjitha hapësirat shqiptare në ish-Jugosllavi, në të cilën përgatitja fetare dhe profesionale bëhej në gjuhën shqipe. Në vitin 1979, Kryesia e Bashkësisë Islame mori vendim ta ndërtonte një godinë të re që do të ishte adekuate dhe do t'i plotësonte nevojat e kërkesat e një shkolle të mesme. Kjo iniciativë u kurorëzua me sukses në vitin 1984, kur medreseja filloi punën në godinën e re, e cila i plotësonte kushtet për zhvillimin dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor. Tani procesi mësimor në Medrese zhvillohet sipas plan-programit të miratuar nga Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës dhe Ministria e Arsimit të Kosovës. Përveç aktivitetit të saj edukativo-arsimor, pas viteve ‘90 në Kosovë, medreseja ka luajtur një rol të rëndësishëm në mbajtjen e aktiviteteve të rëndësishme me karakter politik dhe kulturor. Gjatë viteve 1989-1999 në medrese u mbajtën 1,230 tubime të karakterit politik, kulturor e arsimor. Në medrese ishin bërë të gjitha përgatitjet për konstituimin e Parlamentit të Kosovës më 23 qershor 1992, por forcat serbe e rrethuan medresenë me tanke dhe nuk lejuan mbajtjen e mbledhjes. Nga bankat e kësaj medreseje 87 nxënës iu bashkuan radhëve të UÇK-së, 14 nga të cilët ranë dëshmorë. Nga viti 2014, sikurse shumica e shkollave të mesme në Kosovë, edhe medreseja është bërë trevjeçare. (Ramadan Shkodra)

MEDRESEJA E PRESHEVËS. Nisi punën në vitin 1935 dhe në të ndoqën mësimet fetare nxënës nga Presheva dhe rrethina e saj, si dhe nga Bujanoci, Kamenica, Gjilani etj. Në Medresenë e Preshevës morën diploma tri gjenerata studentësh (mësimet e një gjenerate zgjatnin 10-12 vjet). Shumica e nxënësve, pas përfundimit të medresesë, kryenin detyra të ndryshme qoftë në institucionet islame, qoftë në ato shtetërore. Medreseja dhe konvikti i saj financoheshin nga donatorë të ndryshëm. Medreseja funksionoi deri në vitin shkollor 1947/48, kur u mbyll nga pushteti i atëhershëm. Godina e medresesë u rindërtua në vitin 2010 dhe aktualisht shfrytëzohet nga Këshilli i Bashkësisë Islame të Preshevës. Në vitin shkollor 2014/15 në godinën e medresesë u vendos paralelja e ndarë e vajzave të Medresesë

së mesme “Gazi Isa beu” me qendër në Novi-Pazar. (Hatixhe Ahmed) i)

MEDRESEJA E PRIZRENIT. Shkollë e mesme fetare islame, e themeluar në vitin 1993, me vendim të Kuvendit të Bashkësisë Islame të Kosovës. Punën e filloi si paralele e ndarë e Medresesë “Alaudin” në Prishtinë, paralele për djem. Ishte kjo rihapje e Medresesë “Mehmed Pasha”, e cila funksionoi në Prizren deri në vitin shkollor 1947/48 kur u mbyll nga pushteti i atëhershëm. Plani dhe programi i shkollës është i aprovuar nga Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (MASHT) të Kosovës dhe përmban lëndë fetare islame, por edhe lëndë të përgjithshme të shkencave shoqërore dhe natyrore. Mësimi dhe administrata mbahen në gjuhën shqipe, ndërsa mësohen edhe arabishtja, turqishtja dhe anglishtja. Nxënësit diplomohen me dhënien e testit të maturës, që e organizon MASHT-i, i cili është i njëjtë me testin për nxënësit e gjimnazit të përgjithshëm. Medresenë e Prizrenit e frekuentojnë kryesisht nxënësit nga komuna e Prizrenit, e Dragashit, e Suharekës, e Rahovecit dhe e Malishevës. Të diplomuarit në këtë medrese i vazhdojnë studimet në universitete të ndryshme, brenda dhe jashtë vendit. Një numër syresh janë punësuar në Bashkësinë Islame, të tjerët në organizata dhe institucione të ndryshme të vendit. (Miftar Ajdini)

MEDRESEJA E VAJZAVE NË PRISHTINË. Paralele e Medresesë “Alaudin” për shkollimin e vajzave. Vendimi për hapjen e paraleles për vajza në kuadër të Medresesë “Alaudin” është marrë nga Kuvendi i Bashkësisë Islame të Kosovës më 1997, pas kërkesë që kishte bërë drejtorja e Medresesë në Kryesinë e Bashkësisë Islame të Kosovës. Kështu, në kuadër të Medresesë “Alaudin” të Prishtinës nga viti 1997, krahas shkollimit të djemve, nisi edhe shkollimi i rregullt i vajzave. Vajzat edhe më parë mund të ndiqnin mësimin në këtë medrese, por vetëm me korrespondencë. (Ramadan Shkodra)

MEDRESEJA E VAJZAVE NË PRIZREN. Shkollë e mesme fetare islame, e themeluar më 1997, me vendim të Kuvendit të Bashkësisë Islame të Kosovës, në kuadër të Medresesë së Prizrenit, paralelja për vajza. Kur u themelua ishte e para e këtij lloji në mbarë hapësirat shqiptare, ndërsa në qytetin e Prizrenit u

vazhdua një traditë e pasur e shkollimit fetar. Plani dhe programi i shkollës është i njëjtë me paralelen e djemve të po kësaj medreseje. Pjesën më të madhe të kuadrit arsimor e përbëjnë mësimdhënëset femra. Si dhe në paralelen e djemve, medresenë e vajzave e frekuentojnë kryesisht nxënëse nga territori i komunave të Prizrenit, të Dragashit, të Suharekës, të Rahovecit dhe të Malishevës. Viteve të fundit në këtë medrese i marrin mësimet edhe një numër vajzash nga Shqipëria. Shumica e nxënësve të diplomuara i vazhdojnë studimet në universitete të ndryshme brenda dhe jashtë vendit. (Miftar Ajdini)

MEDRESEJA E VJETËR E PEJËS. Ishte ndër medresetë më të vjetra në Kosovë. Është lënë vakëf nga Mehmet Beu nga Peja në vitin 1516. Medreseja nuk u ndërtua pranë xhamisë, siç ishte traditë. Ajo paraqet një kompleks të veçantë, i plotësuar me godinën e bibliotekës. Ka pasur shtatë dhoma dhe mësonjëtorja. Vendin qendror në oborr e zinte mësonjëtorja, kurse në anën hyrëse kishte divanhanen e hapur. Në këtë medrese dihet se dhanë mësim: haxhi Abdullah Rushdiu, haxhi Hysejn Hysni, Hafiz Ahmet Hamdiu dhe haxhi Daut Fuadi, që të gjithë nga Peja. Kjo medrese funksionoi deri në vitin 1948. (Sadik Mehmeti)

MEDRESEJA E VOGËL E GJAKOVËS. U ngrit rreth vitit 1807 dhe e mori këtë emër, sepse u themelua më vonë se Medreseja e Madhe. Myderrizi i parë i kësaj medreseje ka qenë Tahir efendi Gjakova, i njohur edhe si shkrimtar, poet dhe njëri nga intelektualët shqiptarë më të shquar në gjysmën e parë të shek. XIX. Myderrizë të tjerë të kësaj medreseje ishin: Ali Mici, Hasan Shllaku, Haxhi Ali-Myrteza Luzha, Fetah Buza, Haxhi Emin Hoxha, Haxhi Jusuf Çarkaxhiu, Bajram Jusuf Doli, Hafiz Ibrahim Pallaska, Jahja Bakalli etj. Për arsye të famës që fitoi, këtë medrese e ndiqnin edhe nxënës nga rajonet e Novi-Pazarit, Toplicës, të Plavës dhe të Bosnjës. Medreseja punoi deri në vitin 1948. (Sadik Mehmeti)

MEDRESEJA MEDAH, SHKUP. U themelua nga pushtuesi i Shkupit, Jigit Pasha (1398), e cila funksionoi pa ndërprerje deri në kohën e luftërave ballkanike. Më 1923 medreseja u rihap me emrin “Medah”, por u njoh më shumë si Medreseja e Ataullah Efendisë. E

kishte selinë afër Xhamisë Medah, në Bit Pazar të Shkupit. Kishte sistem të mbyllur shkollimi, konviktin e vet, rend shtëpiak dhe disiplinë rigoroze. Të gjitha lëndët mbaheshin në gjuhën arabe. Kohëzgjatja e mësimit kapte periudhën prej 12-15 vjet, derisa nxënësit t'i përvetësonin lëndët e parapara nga myderrizi. Medreseja kishte statusin e shkollës private dhe financimi i saj bëhej mbi baza vullnetare. Gjatë kohës sa funksionoi kjo medrese (1923-1946) u diplomuan mbi 80 nxënës nga Shkupi, Presheva, Gostivari, Hogoshti, Kumanova etj., shumë nga të cilët u përfshinë në radhët e Lëvizjes Nacional-Demokratike Shqiptare (NDSH). (Elez Ismaili)

MEDRESETË E PERIU DHËS OSMANE. Institucione të arsimit të mesëm e të lartë fetar islam. Ishin pjesë e sistemit të vakëfeve, financiarisht ishin të pavarura dhe i zhvillonin aktivitetet nën mbikëqyrjen e shtetit. Medreseja e parë në Kosovë u themelua në Vushtrri në gjysmën e parë të shek. XV nga Gazi Aliu beu, pastaj në vitin 1516 në Pejë nga Mehmet Beu, pastaj medreseja e Gazi Mehmet Pashës në Prizren e vitit 1537 etj. Më pas u hapën medrese edhe në qytete të tjera, kurse në shek. XVIII numri i tyre u shtua. Në shek. XIX dhe në fillimi të shek. XX në Kosovë ekzistonin 16 medrese: katër në Prizren, dy në Prishtinë, dy në Gjakovë, dy në Pejë, dy në Vushtrri, një në Mitrovicë, një në Gjilan, një në Opojë dhe një në Dobërçan, të cilat i vijonin një numër i madh nxënësish nga treva të ndryshme, madje edhe nga jashtë Kosovës. Të gjitha medresetë nuk kanë qenë të të njëjtit nivel. Disa prej tyre, për shkak të lëndëve që mësoheshin aty dhe autoritetit që gëzonin myderrizët e tyre, krahasoheshin me medresetë e larta të rangut të Fakultetit "Fatih" të Stambollit, si Medreseja "Mehmet Pasha" në Prizren, "Medreseja e Madhe" në Gjakovë etj. Nxënësit në medrese regjistroheshin pasi përfundonin shkollën fillore (mejtepin), ose më vonë, pasi përfundonin edhe shkollën e mesme të ulët (rushdije). Pas kryerjes së medresesë, kandidatëve u jepej diploma mbi kryerjen e shkollës, me çka ai fitonte edhe licencën për mësimdhënie. Kohëzgjatja e mësimit në medrese ka qenë 12-16 vjet. Në medrese mësoheshin këto lëndë me disiplinat e tyre: komentimi i Kuranit, shkenca për traditën, doktrina/apologjetika, e drejta e sheriatit, burimet e së drejtës së sheriatit, e

drejta trashëgimore, gramatika dhe sintaksa e gjuhës arabe, osmane dhe persiane, leksikografia, retorika, metrika, kaligrafia, shkencat e natyrës, logjikë, matematikë, histori e profetëve etj. Medresetë në Kosovë ishin të tipit të medreseve të vogla, rëndom në kuadër të xhamisë ose si godina të veçanta. Nga ana arkitektonike nuk kanë qenë godina monumentale dhe u përgjigjeshin mundësive të donatorëve. Për mbajtjen e tyre janë lënë objekte ekonomike, si dyqane, mullinj, ara, male etj., ose të holla të gatshme, në mënyrë që të siguroheshin të ardhurat për personelin mësimor dhe për mirëmbajtjen e medreseve. Shumë nga myderrizët dhe nxënësit e medreseve kanë marrë pjesë dhe kanë luajtur rol në të gjitha lëvizjet politike shqiptare, si në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, në Lidhjen e Pejës etj. (Sadik Mehmeti)

MEDVEGJA. Qytezë dhe qendër e komunës me të njëjtin emër. Është qendër rajonale e Jabllanicës së Epërme. Është zhvilluar në afërsi të grykëderdhjes së lumit të Llapashticës



MEDVEGJA

në atë të Jabllanicës, degë e majtë e Moravës Jugore, në lartësi mbidetare 350 m. Sipërfaqja e territorit urban është 135 ha, ndërsa sipërfaqja e komunës kadastrale është 1,983 ha. Medvegja deri vonë ka qenë vendbanim i vogël. Ajo në vitin 1890 kishte 74 shtëpi dhe 494 banorë. Në regjistrimin e bërë pas dhjetë vjetësh, numri i popullsisë dyfishohet dhe arrin në 852 banorë. Kjo është bërë në sajë të kolonizimit të rrethinës së Jabllanicës me popullsi malazeze, në tokat nga të cilat ishin dëbuar shqiptarët. Derisa në vitin 1961 qyteza e Medvegjës kishte 2,188 banorë, në vitin 2002 ajo ka 2,810 banorë rezidentë. Shpërngulja, e cila ka vazhduar me intensitet të pandërprerë, ka qenë njëra nga

arsyet kryesore të shtimit të vogël të numrit të banorëve. Me rreth 3,000 banorët e saj, Medvegja nuk e plotëson kriterin demografik për t'u konsideruar vendbanim urban, por këtë status e fitoi në sajë të kriterit administrativ dhe funksioneve që ushtrohen në të. Pas Luftës së Dytë Botërore zhvillohet një industri modeste, ndërsa vazhdon t'i ruajë veçoritë e një qendre tregtare e zeytare. Si qendër komunale Medvegja ushtron edhe funksione të tjera administrative, arsimore, shëndetësore etj. (Arsim Ejupi)

MEDVEGJA (komuna). Nodohet në pjesën e sipërme të pellgut të luginës së lumit Jabllanica, në lartësi mbidetare ndërmjet 316 dhe 1376 m. Nga Rrafshi i Kosovës e ndan masivi malor i Gollakut, në lindje kontakton me luginën e Moravës Jugore, ndërsa në verilindje zbrit në fushën e Leskocit. Në perëndim dhe në jug, në një gjatësi prej 40 km, kufizohet me komunën e Prishtinës, të Podujevës dhe të Kamenicës, ndërsa në veriperëndim kufizohet me komunën e Kurshumlisë në Serbi, në lindje me komunën e Lebanës, kurse në veri me Bojnikun dhe Prokuplen. Lidhjet komunikative me Rrafshin e Kosovës në lindje dhe me fushën e Leskocit në perëndim, Medvegja i realizon përmes qafave malore, përkatësisht luginës së lumit Jabllanica. Dominon relievi kodrinor-malor i copëtuar me lugina të thella lumore. Në ndërtimin gjeologjik marrin pjesë pesë komplekse të shkëmbinjeve sedimentarë të lidhur dhe gjysmë të lidhur, karbonatikë, vullkanogjenë etj. Klima është e mesme kontinentale. Temperatura mesatare vjetore në viset fushore është 11^o C, ndërsa 6.7^o C në ato malore. Sasia mesatare e reshjeve sillet nga 600-700 mm. Rrjetin hidrografik të komunës së Medvegjës e përbën lumi Jabllanica me degët: Banjska, lumi i Tullarit, Gajtanit dhe Llapashticës. Janë të rëndësishme sidomos ujërat termominerale të Banjës së Sijarinës dhe Tullarit. Nga resurset natyrore duhen veçuar pyjet me 45.1% të territorit të komunës, pastaj vendburimet e arit, plumbit dhe zinkut, të bakrit, të oniksit, të mermerit etj. Komuna e Medvegjës është përfshirë nga proceset regresive demografike. Në vitin 2002 në këtë komunë jetonin 10,760 banorë, që është 17% më pak se në vitin 1991. Komunën e përbëjnë 44 vendbanime. Popullsia shqiptare jeton në Medvegjë, Tupallë, Sijarinë dhe Banjë të Sijarinës, Kapit, Gërbavc, Svirçë, Ramabajë, Starabajë dhe Gyjekare. Derisa në

vitet '80 të shekullit të kaluar në komunën e Medvegjës rreth një e treta e popullsisë kanë qenë shqiptarë, sot ky numër ka rënë në disa qindra. Komuna e Medvegjës me vetëm 24.8% të të ardhurave kombëtare për kokë banori në raport me mesataren e vendit dhe me shkallë të papunësisë prej 32.4% është një ndër komunat më të pazhvilluara në Serbi. (Arsim Ejupi)

MEFMETI Mefail (Mefaili i Vogël) (?-1946). Lindi në fshatin Zajaz (Kërçovë). Prej ditëve të para të Luftës së Dytë Botërore iu bashkëngjiti njësiteve vullnetare të Mefail Shehut (Mefailit të Madh) në luftë kundër njësiteve bullgare dhe atyre komuniste. Nga Mefail Shehu u caktua komandant i njësiteve ushtarake. Luftën e armatosur e vazhdoi edhe pas nëntorit të vitit 1944 në malet e rrethit të Kërçovës, me një numër luftëtarësh, deri në shkurt të vitit 1946, kur komunistët i bien në gjurmë, e rrethojnë dhe e ekzekutojnë. Trupi iu ekspozua në qendër të Kërçovës dhe u varros pa ceremoni afër kazermave ushtarake të Kërçovës. (Riza Sadiku)

MEGALI IDEA (IDEJA E MADHE). Platformë nacionaliste e bazuar në idenë e ringjalljes territoriale të Perandorisë Bizantine, që dominoi politikën e jashtme të shtetit grek në gjysmën e dytë të shek. XIX dhe në fillim të shek. XX. Fillesat e "Megali idesë" i gjejmë në shek. XVIII në radhët e përfaqësuesve të diasporës greke në Austri, Rusi dhe në Perandorinë Osmane. Plotësimi me elemente të filozofisë politike, mendohet të jetë vepër e "Fanariotëve" (rrethe me ndikim i bashkësisë greke në Stamboll). Qëllimi final i tyre ishte ringritja e Perandorisë Bizantine si shtet shumëkombësh, me qendër Konstandinopojën, të drejtuar nga fisnikëria greke dhe me greqishten si gjuhë zyrtare. Më 14 janar 1844, kryeministri grek Janis Koletis e shpalli "Megali idenë" program të plotë politik. Që nga ai moment e deri në vitin 1923, ajo ishte shtylla kryesore e politikës së jashtme të Greqisë dhe fjala mbizotëruese në fjalorin diplomatik grek. Boshtet kryesore të "Megali idesë" ishin trashëgimia historike, e mishëruar tek ortodoksia dhe bizantinizmi e greqishtja si gjuhë sunduese e tyre. Çlirimi i "grekëve të robëruar" nga sundimi osman dhe unifikimi i "tokave që banoreshin prej tyre" në një shtet të vetëm përbënin dy qëllimet themelore të saj. Kufijtë e Greqisë së

pretenduar do të zgjeroheshin në jug përgjatë ishujve të Egjeut dhe Kretës, dhe në veri, duke u shtyrë në Thesali, Maqedoni dhe Epir. Për realizimin e “Megali idesë” u kombinuan metodat ushtarake me ato kulturore. Rruga ushtarake parashikonte luftë të hapur me Perandorinë Osmane, duke hedhur në kryengritje edhe popullsinë e zonave, që pretendoheshin se ishin greke. Rruga kulturore synonte, nëpërmjet një programi arsimor dhe propagandës kulturore, të krijonte “identitetin helen” te popullsia ortodokse në zonat e pretenduara. Si platformë nacionaliste me objektiva të qarta territoriale, “Megali ideja” kushtëzoi dhe vështirësoi marrëdhëniet e Greqisë me fqinjët. Pretendimet greke për territore të vilajetit të Janinës dhe të Manastirit, pjesë e shtetit të pavarur shqiptar që prej 1913-ës, acaruan marrëdhëniet e Greqisë me Shqipërinë. (Ledia Dushku)


MEHA Beqir (1936-1999). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), dëshmor. Lindi në Prekaz të Skënderajt. Veprimtarinë atdhetare e filloi që në rini, si anëtarë i organizatës ilegale “Vuajtjet”, që ishte formuar në Prekazin e Epërm. Me zbulimin e organizatës në vitin 1959, u burgos dhe u dënua me 2 vjet heqje lirie. Pas luftës së Tahir Mehës (vëllait të tij) me forcat jugosllave më 13 maj 1981, B. Meha u akuzua se i ka ndihmuar vëllait të tij, me ç’rast u burgos sërish. Nga viti 1992 kaloi në ilegalitet, duke u angazhuar në celulat e para të UÇK-së. Ishte bashkëluftëtar i komandantit Adem Jashari. U emërua nga shtabi i UÇK-ës në Likoc si toger i njësiteve speciale të policisë së UÇK-ës për gjithë territorin e Kosovës. Mori pjesë në shumë beteja. Më 25 mars 1999 ra heroikisht në fshatin Qubrel. (Teuta Shala-Peli)

MEHA Murat (1956-). Inxhinier i gjeodezisë, profesor universiteti. Lindi në Prekaz, komuna e Skënderajt. Shkollimin fillor dhe të mesëm i kreu në vendlindje, ndërsa Fakultetin e Gjeodezisë dhe studimet pasuniversitare në Universitetin e Zagrebit. Mbrojti disertacionin në Universitetin Politeknik të Tiranës. Është profesor i rregullt në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe të Arkitekturës të Universitetit të Prishtinës (UP). Ka mbajtur trajnime dhe studime plotësuese në disa vende të Europës dhe në Japoni. Ishte udhëheqës gjeodezie në “Ferronikel” të Drenasit në periudhën 1980-1991, pas luftës menaxher i kësaj fabrike (1999-2005) dhe më

pas kryeshef ekzekutiv i Agjencisë Kadastrale të Kosovës. Menaxhoi projektet për krijimi e kadastrës digjitale, për krijimin e sistemit të informacionit kadastral për tokën e Kosovës, për sistemin e adresave dhe të hartave topografike etj. Ka publikuar një sërë punimesh në revista profesionale e shkencore dhe ka marrë pjesë në simpoziume, konferenca dhe kongrese për kadastrë, gjeodezi, hartografi, administrim dhe menaxhim të tokës. Është autor i disa teksteve profesionale dhe të përkthyer, autor i katër at-laseve gjeografike dhe pesë hartave tematike të Kosovës. Nga viti 2008 është kryetar i komisionit shtetëror për demarkacionin e kufirit të shtetit të Kosovës me shtetet fqinje. (Naser Kabashi).

MEHA Tahir (1943-1981). Luftëtar kundër pushtetit jugosllav. Lindi në Prekaz të Ulët në Skënderaj. Si i ri punoi në Maqedoni, në Mal të Zi e më vonë edhe në Austri. U kthye sërish në vendlindje. Në vitin 1979 ra në konflikt me pushtetarët lokalë. Në muajin prill të vitit 1980 policia lokale organizoi një pritë për ta burgosur. Pas gjashtë muajve të kaluara në qeli, u shpall fajtor dhe e dënua me një vit burg, të cilin duhej ta mbante më vonë. Pas disa muajsh e thirrën të paraqitej në polici, por nuk e zbatoi urdhrin. Në një aksion që u zhvillua për kapjen e tij, u plagos ai dhe një polic. Disa muaj jetoi ilegalisht te miqtë dhe te të afërmit e tij. Më 13 maj 1981 forca të mëdha policore e rrethuan shtëpinë e Mehajve në Prekaz të Ulët, me qëllim të arrestimit të tij. T. Meha nuk u dorëzua, por iu kundërvu me armë njësiteve të policisë. Pas një beteje njëditore, me pjesëmarrje të forcave speciale dhe njësiteve të blinduara, T. Meha u vra, bashkë me babanë e tij, Nebiun. Numri i policëve të vrarë në këtë përballje nuk u bë i ditur. (Haki Kasumi)

MEHDIU Feti (1944-). Filolog, orientalist, përkthyes, profesor universiteti. Lindi në Zajaz të Kërçovës, Maqedoni. Shkollimin fillor e përfundoi në vendlindje, tetëvjeçaren dhe medresenë në Prishtinë. U diplomua për orientalistikë në Beograd, ku kreu edhe studimet pasuniversitare, kurse doktoror në Prishtinë (1990). Në vitin 1973 angazhohet me punë në Institutin e Historisë. Një vit më vonë (1974) zgjidhet asistent i gjuhës arabe në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës, duke i kaluar radhazi të gjithë titujt universitarë. Është themelues i Shoqatës së Orientalistëve të



FETI MEHDIU

Kosovës (2000), anëtar korrespondent i Akademisë Arabe të Shkencave në Damask (2002). Botoi studime, monografi, vepra autoriale dhe të përkthyer: “Reflektime të luftës së shqiptarëve për pavarësi 1389-1999: në burime orientale” (2012), “Përkthimet e letërsisë arabe në gjuhën shqipe 1922-1982” (2008) etj. Është i pari përkthyes i tërë Kuranit në gjuhën shqipe (1985). Mori pjesë në disa simpoziume dhe konferenca shkencore ndërkombëtare. (Jahja Hundozi)

MEHMEDI Qani (1953-2017). Gazetar. Lindi në Kërçovë. Shkollimin fillor e kreu në vendlindje, gjimnazin në Tetovë, Fakultetin Juridik në Prishtinë, në drejtimin gazetari-diplomaci, ku edhe kreu studimet pasuniversitare. Ishte redaktor në gazetën e studentëve “Bota e re”, zëvendëskryeredaktor në revistën “Zëri i rinisë”, redaktor në Televizionin e Kosovës, reporter në Radion Kombëtare të Kroacisë, redaktor në Radio-Tirana dhe në Radiotelevizionin Shqiptar. Pas luftës një kohë ishte kryeredaktor i së përditshmes “Lajm” dhe themelues dhe kryeredaktor i Televizionit “Uskana” në Kërçovë. Ka shkruar artikuj dhe komente për të përditshmen “Rilindja” dhe gazetat “Danas” të Zagrebit dhe “Oslobogjenja” të Sarajevës. Është autor i librit “Shtetformimi i Kosovës”. Është bartës i çmimeve dhe mirënjohjeve nga fusha e gazetarisë (Shefqet Rexhepi)

MEHMETAGAJ-KAJTAZI Venera (1960-). Flautiste. Lindi në Prizren. Gjatë shkollimit u dallua për talentin muzikor. Si 14-vjeçare u bë anëtare e Orkestrës Simfonike të Radiotelevizionit të Prishtinës (RTP). U diplomua më 1981 në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës (prof. N. Atanasov). Më 1981, si bursiste e qeverisë franceze, u specializua në Paris (prof. P. Y. Artaud, A. Marion), ndërsa u magjistrua më 1990. Ka një karrierë të pasur në koncerte e festivale të ish-Jugosllavisë e



VENERA KAJTAZI-MEHMETAGAJ


më gjerë (Dubrovnik, Opat, Herceg-Novi), me “Rininë muzikore” (Kubë, Kroaci, Spanjë, Francë, Gjermani, Slloveni, Maqedoni etj.), me ansamble, orkestra e filarmoni brenda dhe jashtë vendit, me dirigjentë si: B. Çela, M. Jagust, I. Kuleriç, N. Kodali, A. Sporri, R. Tisseo, V. Pavlovski, L. Sallatsky, Zh. Zdravkoviç, S. Pantiru, E. Koço, F. Deda, Zh. Ciko, J. Barbullushi, T. Yanagisava. Ka incizuar për nevojat e produksioneve muzikore të radiotelevizioneve të ndryshme (RTP, Radiotelevizioni Shqiptar, Radiotelevizioni i Zagrebit etj.). Ka botuar një CD me vepra për flaut. U nderua me mirënjohje dhe diploma nga shoqatat muzikore në vend e më gjerë. Në vitet 1984-1992 ishte profesoreshë e flautit në Skollën e Mesme të Muzikës në Prishtinë, ndërsa nga viti 1992 është profesoreshë e rregullt në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. (Sami Piraj)

MEHMETAJ Ali (1950-). Gazetar, botues. Lindi në fshatin Dubovë të Pejës. Mbaroi studimet për gjuhë dhe letërsinë shqipe në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Punoi një kohë të gjatë gazetar dhe përkthyes në Radiotelevizionin e Prishtinës, pastaj redaktor dhe kryeredaktor i disa revistave humoristike-satirike dhe të tjera, si: “Horri”, “Anza”, “Dielli”, “Viktoria” etj. Ishte botues i të përditshmes “Dardania”, pastaj i revistës humoristike “Morri”, revistës për të rinj “Titanik” dhe i revistës për fëmijë “Vizatori” dhe i asaj letrare “Verbi”. Është autor i librave “Gungaçi dhe djalli”, “Kësula magjike”, “Një përmendore për gomarin”, “Njeriu misterioz” etj. (Shaqir Foniqi)

MEHMETAJ Faton (1963-). Gazetar. Lindi në Pozhar të Deçanit. Shkollën fillore e kreu në Irzniq, të mesmen në Deçan, studioi për gjuhë dhe letërsi në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Prishtinës. Si gjimnazist u angazhua në lëvizjen ilegale dhe në vitin 1986 u arrestua sa ishte ushtar në Lubjanë dhe u dënua me 13.5 vjet burg. U lirua nga burgu në shtator 1989, me amnistinë e përgjithshme në ish-Jugosllavi. Ishte njëri ndër bashkëthemeluesit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) dhe anëtar i Shtabit Operativ të Rrafshit të Dukagjinit të UÇK-së. Ishte kryeredaktor i revistës së parë ushtarake të TMK-së “Ardhmëria”, organ i Zonës së Tretë të Mbrojtjes në Pejë (1999-2001). Është autor

dhe bashkautor i disa librave nga fusha e publicistikës dhe letërsisë: “Lufta për kufijtë e Shqipërisë Etnike 1941-1945” (1995), “Nëpër shtigjet e historisë” (1997), “Adrian Krasniqi, ‘Rexha’” (2001), “Kosova dhe sfidat e sigurisë” (2009) etj. (Rrahman Paçarizi)

MEHMETAJ Gani (1955-). Publicist, kritik i filmit. Lindi në Dubovë të Pejës. Shkollimin fillor e kreu në vendlindje, gjimnazin në Pejë, ndërsa studimet për gazetari në Fakultetin



GANI MEHMETAJ

Juridik të Universitetit të Prishtinës. Punoi në të përditshmen “Rilindja” nga viti 1979 deri më 1999, ku shkroi ese dhe recensione për filmin, reportazhe e komente për kulturën, intervista me personalitete të kulturës dhe të artit. Ishte drejtor ekzekutiv dhe analist i së përditshmes “Bota sot” dhe kryeredaktor i revistës “Anza”. Pas vitit 2000 botoi disa libra eseistikë dhe publicistikë: “Magjia e ekranit” (2005), “Për shtetin e Dardanisë” (2006), “Dardani a Shqipëri etnike” (2007), “Udhëkryqet pas Rugovës” (2007), “Shqiptarët në vllimet ballkanike-1990-1999” (2008), “Sharmi i filmit” (2010), “Kosova: Sfidat e pavarësisë” (2010) etj. Është autor i librit me tregime “Kujtime të trishta” (2010) dhe i romaneve “Qyteti në ankth” (2011) e “Aventurat e Lulisë” (2012). Në vitin 2015 botoi përmbledhjen e dramave me titullin “Nata e fantazmave”, ku janë përfshirë katër drama. Ka qenë drejtor dhe producent i “Kosovafilmit”. (Visar Krusha)

MEHMETAJ Haxhi (1952-). Arkeolog. Lindi në Dubovë të Pejës, arsimin themelor e mori në Dubovë dhe Pejë, ndërsa studimet për arkeologji dhe filozofi në Universitetin e Zarës. Punoi në Institutin e Monumenteve dhe Muzeun Rajonal të Prishtinës (1983-2013), të cilin e udhëhoqi në vitet 1999-2013. Fushë të ngushtë të studimeve e ka epokën e bronzit dhe të hekurit, por merret edhe me periudhën antike. Drejtoi një sërë ekspeditash arkeologjike, si dhe botoi shumë artikuj profesionalë e shkencorë dhe mori pjesë në konferenca shkencore kombëtare e ndërkombëtare. Është bashkautor i monografisë “Trashëgimia etnokulturore dhe historike e Llapit” (1995), “Gallapi gjatë rrje-

dhave të historisë” (2010) dhe “Lashtësia e Fushë Kosovës” (2013). Ishte anëtar i redaksisë dhe hartues i njësive “Vushtrria” në “Hartën arkeologjike të Kosovës” II (2013). Punoi në Institutin Arkeologjik të Kosovës në Prishtinë. (Arben Hajdari)

MEHMETI Beqir (1939-). Inxhinier i xehtarisë, profesor universiteti. Lindi në Mitrovicë. Studimet për xehtari i kreu në Fakultetin e Xehtarisë dhe të Gjeologjisë të Universitetit të Beogradit (1967). Studimet pasuniversitare i kreu po aty, ndërsa tezën e doktoratës e mbrojti në Fakultetin e Xehtarisë në Tuzell (1984). Pas kryerjes së fakultetit një vit punoi në mihjen sipërfaqësore të Mirashit. Më pas, deri në vitin 1990, punoi në minierën “Trepça” të Stantërgut. Ndërkohë, në Shkollën e Lartë Teknike mbajti disa lëndë profesionale, të cilat më pas i ligjëroi për vite me radhë edhe në Fakultetin e Xehtarisë dhe të Metalurgjisë. Ishte pjesëmarrës i revidimeve të projekteve dhe studimeve të disa minierave të “Trepçës”. Ishte edhe anëtar i asociacioneve për mekanikën e shkëmbinjve dhe punimeve minerare, autor dhe bashkautor në hartimin e teksteve shkollore, dispensave dhe i disa publikimeve dhe elaboreve profesionale. (Izet Zeqiri)

MEHMETI Bujar (1981-). Gazetar i sportit. Lindi në Prishtinë, ku kreu shkollën fillore, të mesme dhe Fakultetin Juridik. Me gazetari sportive nisi të merret fillimisht në gazetën sportive “Kosova sport” (2001-2004). Më pas kaloi në të përditshmen “Lajm”, po ashtu në fushën e gazetarisë sportive (2004-2008). Ka qenë redaktor i sportit në gazetën e përditshme “Sport”, për të kaluar në “Kohavision” si gazetar/komentator i sportit. (Edmond Thaçi)

MEHMETI Din (1929-2010). Poet. Lindi në Gjocaj të Junikut, ku kreu shkollën fillore. Shkollën normale e kreu në Gjakovë, studimet në Universitetin e Beogradit, në katedrën



DIN MEHMETI

për gjuhë e letërsi shqipe. Mbaroi studimet pasuniversitare në katedrën e albanologjisë të Universitetit të Prishtinës. Në fillim punoi si gazetar në të përditshmen “Rilindja”, më pas mësues në Shkollën

Normale dhe në Gjinnazin e Gjakovës. Derisa u pensionua ishte profesor i letërsisë popullore dhe i teorisë së letërsisë në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Gjakovë. Vjershën e parë e botoi më 1949 te revista letrare “Jeta e re”. Më pas botoi veprat: “Në krahët e shkrepave” (1961), “Rini diellore” (1966), “Dridhjet e ditës” (1969), “Heshtja e kallun” (1972), “Ora” (1974), “Ikja nga vdekja” (1978), “Fanar në furtunë” (1981), “Zogu i diellit” (1982), “Agu” (1982), “Fatin tim nuk e nënshkruaj” (1984), “As në tokë as në qiell” (1988), “Gjaku që këndon” (1993), “Prapë fillimi” (1996), “Mos vdis kur vdiset” (2001), “Lumturia është mashtrim” (1999). Në letërsinë shqipe të Kosovës, D. Mehmeti u shfaq bashkë me brezin e avancuar poetik të Besim Bokshit, Azem Shkrelit, Fahredin Gungës etj. Ishte zë në vete, që mbështetej dhe frymëzohej sidomos nga letërsia gojore. Që andej e ndjente jehonën e dramës historike të truallit të vet, ëndrrat e tij nëpër mote. Është për t’u theksuar fakti që D. Mehmeti shumë shpejt, në fillim të krijimtarisë, e parandjeu se ëndrra e tij nuk po realizohej siç ishte premtuar dhe siç besohej, prandaj ndër të parët dha alarmin përmes lirikës dramatike për shpërnguljen kolektive të shqiptarëve nga Kosova. Këtë shqetësim drithërues, të thellë, do t’ua ngarkojë vargjeve të tij deri në fund të jetës. Sidomos gjatë dhjetëvjetëshit të fundit të shek. XX, me katër librat e tij të fundit poetikë, verbi i tij krijues ka shijen e klithjes dhe rezistencës ndaj dhunës, e cila ushtrohej ndaj vendit dhe popullit të tij. Është autor edhe i shkrimeve në prozë, autor drame dhe i studimeve letrare, sidomos nga letërsia popullore. Poezia e tij është përkthyer në disa gjuhë të huaja dhe është përfshirë në antologji. Ishte laureat i disa çmimeve të rëndësishme letrare. (Ali Aliu)

MEHMETI Enver (1948-). Profesor i letërsisë popullore, studiues i folklorit. Lindi në Vojnoc (Shtime). Kreu shkollimin fillor në vendlindje, gjinnazin në Prishtinë, studimet për gjuhë dhe letërsi në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës (UP). Në viti 1975 u zgjodh asistent dhe deri më 2013, kur u pensionua me gradën e profesorit të rregullt, punoi si mësimdhënës i letërsisë popullore në degën e letërsisë shqipe të Fakultetit të Filologjisë të UP-së. Kreu edhe një sërë funksionesh në këtë fakultet dhe në organet drejtuese të UP-së. Një kohë ligjëroi edhe në Universitetin Shtetëror të Tetovës. Është

autor i disa studimeve që trajtojnë strukturën artistike të epikës popullore dhe ka botuar monografitë: “Tematika e këngëve kreshnike” (1979) dhe “Marrëdhëniet dhe transformimet e zhanreve të poezisë legjendare dhe prozës popullore” (1989), si dhe përmbledhjen me punime “Studime në fushën e folklorit” (1976). Ka marrë pjesë në tubime të ndryshme shkencore dhe botoi studime dhe artikuj në revista të ndryshme profesionale brenda dhe jashtë vendit. (Arbnora Dushi)

MEHMETI Esat (1951-). Futbollist, trajner. Një prej portierëve më të mirë të Kosovës. Karrierën sportive e filloi në klubin “Llapi” të Podujevës. Në edicionin 1974-1975 bëhet anëtar i KF “Trepça”, ndërsa për një vit luajti edhe për “Vardarin” e Shkupit. Për gjashtë muaj bëri karrierë edhe në Turqi, në radhët e klubit turk “Beshiktas”, por pa mundësi që të luajë më shumë, për shkak se regjimi i atëhershëm nuk e kishte pajisur me dokumentet e nevojshme. Ndërkohë, kthehet në Kosovë për të veshur fanellën e “Lirisë” së Prizrenit, për të cilën luajti tri vjet, më pas kalon te “Buduqnosti” i Pejës, në edicionin 1980/81 kthehet përsëri te “Trepça” e Mitrovicës, ndërsa karrierën e përfundoi në klubin “Llapi” të Podujevës, aty ku kishte filluar. Në vitin 1981 u emërua trajner i “Llapit” të Podujevës, ku zbuloi shumë talentë të futbollit. (Bekim Aliu)

MEHMETI Fetah (1946-2002). Aktor, regjisor. Lindi në Lisockë të Kamenicës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa gjinnazin në Gjilan. Mbaroi studimet për regji filmi në Fakultetin e Arteve Dramatike në Beograd. Në vitin 1968 filloi punë si aktor në Teatrin e Pakicave në Shkup, ku u veçua për rolet në shfaqjet: “Armiku i popullit” në regji të Muharrem Qenës dhe “Karnevalet e Korçës” në regji të Kujtim Spahivoglit, pastaj me rolin në shfaqjen “Familja e peshkatarit” të Sulejman Pitarkës (1977). Si regjisor teatri nisi me dramën “Fosilet” të Azem Shkrelit. Në Teatrin e Gjakovës realizoi regjinë e shfaqjes “Halili dhe Hajria”, ndërsa në Teatrin Popullor Krahinor u veçua për regjinë e shfaqjes “Vegullia” të Beqir Musliut (1988). Për disa vjet punoi si regjisor në Radiotelevizionin e Prishtinës (RTP). Në vitin 1999 emigroi në Suedi. (Arian Krasniqi)

MEHMETI Hajrip (1957-). Agronom, profesor universiteti. Lindi në Kuk, komuna e Dragashit. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, gjimnazin në Prizren (1976), studimet në Fakultetin e Bujqësisë të Universitetit të Prishtinës (1980). Studimet pasuniversitare i përfundoi në Universitetin e Shkupit (1996), ndërsa tezën e disertacionit e mbrojti në Universitetin Bujqësor të Tiranës (2000). Punësohet në Institutin e Blegtorisë dhe të Veterinarisë në Prishtinë, si bashkëpunëtor shkencor (1982), ndërsa më vonë zgjidhet asistent në Fakultetin e Bujqësisë për lëndën zooteknia, duke u avancuar më pastaj në të gjithë titujt universitarë. Ka publikuar punime shkencore dhe ka marrë pjesë me kumtesa në tubime shkencore në vend dhe në botën e jashtme. (Ragip Kastrati)

MEHMETI Hamit (1946-). Inxhinier i metalurgjisë, profesor universiteti. Lindi në Zajaz, Kërçovë. Shkollën fillore e kreu në Zajaz dhe Kërçovë, të mesmen në Veles, Maqedoni. Kreu studimet e rregullta në Fakultetin Teknik të Shkupit, kurse ato pasuniversitare në Freiberg të Gjermanisë. Disertacionin e mbrojti në Universitetin e Prishtinës (UP) (2000). Punoi në Shkollën e Mesme Teknike në Mitrovicë, pastaj në “Ferronikel” dhe më pas nga viti 1978 në Fakultetin Teknik të UP-së dhe në Fakultetin e Xehetarisë dhe të Metalurgjisë në Mitrovicë. Ishte menaxher i Laboratorit Qendror të UP-së (2002-2005) dhe më pas prorektor në Universitetin Shtetëror të Tetovës (2006-2009). Është autor i disa teksteve universitare: “Metalurgjia fizike” (1996), “Riqarkullimi i materialeve” (1997), “Shkenca e materialeve” (2000) etj. Me punime shkencore mori pjesë në disa simpoziume dhe kongrese ndërkombëtare. Përveç në disa njësi akademike të UP-së, mbajti mësim edhe në Universitetin e Tetovës. (Hysni Osmani)

MEHMETI Hasan (1946-). Mjek, stomatolog, profesor universiteti. Lindi në Shitovë të Kërçovës, shkollimin fillor e mbaroi në vendlindje, ndërsa gjimnazin në Prishtinë. Kreu Fakultetin e Stomatologjisë në Shkup (1973). Pas diplomimit punoi në Shtëpinë e Shëndetit në Prishtinë. Specializimin nga ortopedia e nofullave e kreu po në Fakultetin e Stomatologjisë në Shkup. Në seksionin e stomatologjisë të Fakultetit të Mjekësisë u punësua në vitin 1981,

si asistent. Studimet pasuniversitare i mbaroi në Sarajevë, ndërsa disertacionin e doktoratës e mbrojti në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë (1995). Më pas u zgjodh docent, profesor inordinar dhe profesor i rregullt. Ishte shef i Klinikës së Ortodoncisë për shumë vjet. Një mandat ishte edhe drejtor i Qendrës Stomatologjike Universitare të Shkupit. Është autor dhe bashkautor i shumë punimeve shkencore-profesionale. (Fatmir Dragidella)

MEHMETI Ismail (1945-). Gjuhëtar, profesor universiteti. Lindi në Tetovë. U diplomua në Universitetin e Beogradit (1969) për gjuhë dhe letërsi angleze, studimet pasuniversitare i kreu në Zagreb, ndërsa tezën e disertacionit të doktoratës e mbrojti në Prishtinë (1996) rreth disa shprehjeve idiomatike të anglishtes në përkthimet letrare shqipe. Specializoi në Xhorxhtaun të SHBA-së. Ishte mësimdhënës në Universitetin e Prishtinës prej vitit 1970, kurse më 1995 kaloi me punë në Universitetin e Tetovës dhe më pas në Universitetin e Europës Juglindore po në Tetovë. Botoi studime për analizën morfologjike dhe semantike të anglicizmave në shqipen (1982), për përshtatjen gramatikore të anglicizmave në gjuhën shqipe (1985), për idiomat e anglishtes dhe përshtatjen e tyre në shqipen etj. (Lindita Rugova)

MEHMETI Kim (1955-). Romancier, tregimtar, publicist, përkthyes. Lindi në fshatin Gërçec të Shkupit. Themelues i të përjavshmes “Lobi” në Shkup, që nga viti 2002 deri më



KIM MEHMETI

2006. Ishte redaktor i revistës letrare “Jehona”, redaktor i veprimtarisë botuese “Flaka e vël-lazërimit”, redaktor përgjegjës në Radiotelevizionin e Maqedonisë dhe përgjegjës i zyrës së televizionit “Top Channel” në Shkup. Botoi përmbledhjet me tregime: “Pluhuri që mbin” (1986), “Dënesje” (1988), “Bolero” (1991), “Fati” (1992), “Fati i Fatushës” (1994), “Vdekja e magjistares” (1994), “Mbledhësit e luleve të vyshkura” (1995), “Lulehëna (1997), “Fshati pa varreza” (2000), “Shtëpia në fund të fshatit” (2006), “Në xhepin e jelekut të gjyshes” (2007); romanet: “Shtatë net dënesje” (1990), “Fshati i fëmijëve të mallkuar” (1998), “Atje dhe dikur”

(2002), "Ritet e Nishanes" (2004), "Vitet e uritit" (2008), "Koha" (2008), "Kulla dykatëshe" (2009); dhe librat me ese e tekste publicistike: "Kështu ecën njeriu", "Titanë" (2007, 2008), "Prej kali të bardhë deri te rrugaçëria partiake" (2007), "Fara e bimës së keqe" (2008). Temë e preferuar në romanet dhe tregimet e tij është e kaluara historike. E veçanta e prozës artistike të Kim Mehmetit është se edhe te romanet të cilët në fillim mund të duken se janë historikë, në të vërtetë gjithandëj plekset aktualiteti, përditshmëria, por edhe vizionet drejt së nesërme. Dhe hapësira tematike e kohore, edhe pse të përqendruara saktësisht, në prozën e K. Mehmetit universalizohen si vlera njerëzore. Është njëri nga shkrimtarët e përkthyer dhe të vlerësuar nga opinioni i mjediseve ku është botuar. Është i pranishëm në përditshmërinë politike në Maqedoni, si një nga polemizuesit më aktivë dhe më të pasionuar. (Ali Aliu)

MEHMETI Mexhid (1948-). Shkrimtar. Lindi në fshatin Zhunicë të Preshevës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje dhe në Preshevë, ku kreu edhe gjimnazin, ndërsa studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe i mbaroi në Universitetin e Prishtinës. Për disa vjet punoi në gjimnazin "Skënderbeu" në Preshevë, pastaj në shkollën e mesme në Tërnoc të Bujanocit, si dhe në shkollat fillore në Raincë e Corratice. Më pas punoi si përkthyes në gazetën "Flaka e vëllazërimit" në Shkup. Prej vitit 1985 e deri në përfundim të Luftës së Kosovës ishte gazetar-korrespondent i gazetës "Rilindja". Ishte themelues dhe redaktor i revistave "Filizat" dhe "Panorama" të Preshevës dhe "Jehona" të Bujanocit. Shkruan poezi, prozë dhe drama. Vjershën e parë e botoi me 1965 në revistën "Zëri i rinisë". Në vitin 2006 nga Lidhja e Shkrimtarëve të Kosoëvs mori çmimin "Hivzi Sulejmani" për romanin "Shtatë ditë pas vdekjes". Botoi veprat: "Zibardhët" (1998), "Vdekja e hijshme" (1998) etj. Poezitë e tij u botuan në kinezisht (Taipei 2010), boshnjakisht e anglisht, pastaj rumanisht dhe italisht. (Hasan Hasani)

MEHMETI Milajete (1952-). Inxhinierë e teknologjisë, profesor universiteti. Lindi në Mitrovicë, shkollën fillore dhe të mesmen i kreu në vendlindje, Fakultetin Teknik në Prishtinë. Studimet pasuniversitare dhe disertacionin i kreu në Universitetin e Zagrebit (1991).

Fillimisht u punësua në Shkollën e Mesme Teknike në Mitrovicë, pastaj në Fakultetin Teknik të Universitetit të Prishtinës (UP) dhe nga viti 1977 në Fakultetin e Xehetarisë dhe të Metalurgjisë në Mitrovicë. Në gusht të vitit 1999 u bë njëra nga bartëset e projektit të fondacionit gjerman DAAD për ngritjen e Labororit Qendror për Diagnostikimin e materialeve në kuadër të UP-së. Kreu specializime në Freiberg të Gjermanisë dhe në Baltimor, SHBA. Është autore dhe bashkautore e disa teksteve universitare: "Elektrokimia" (1995), "Riqarkullimi i materialeve" (1997), "Korrozioni dhe mbrojtja e materialeve nga korrozioni" (1999) etj. Me punime shkencore mori pjesë në disa simpoziume dhe kongrese ndërkombëtare. (Hysni Osmani)

MEHMETI Nehat (1960-). Aktor, regjisor. Lindi në Kumanovë, ku kreu shkollën fillore dhe të mesme, kurse studimet për aktrim në Fakultetin e Artit Dramatik të Universitetit të Shkupit. Realizoi një sërë rolesh në teatër, në filma artistikë dhe në seriale. Rolet më të rëndësishme i realizoi në shfaqjet: "Mbreti Edip" (1981), "Gjurmë e rrezikshme" (1982), "Boheja" (1982), "Unë Halil Garria" (1984), "Shi në Uetermonte" (1985), "Tartufi" (1986), "Babiloni" (1986), "Ëndërr e një nate vere" (1987). Bëri edhe regjinë e disa shfaqjeve, si: "Jashtë bie borë" (2002), "Pistoleta" (2004), "Piktori" (2005), "Vdekja dhe vasha" (2008) dhe "Audienca" (2009) etj. Disa vjet punoi si mësimdhënës i aktrimit në Universitetin e Tetovës. Punon në Teatrin Shqiptar në Shkup. (Salajdin Salihu)

MEHMETI Ramadan (1948-). Shkrimtar. Lindi në fshatin Livoç i Ulët të Gjilanit. Kreu shkollën fillore në vendlindje, të mesmen në Prishtinë, ndërsa studimet për gjuhë e letërsi shqipe në Universitetin e Prishtinës. Punoi në disa institucione të vendit, si në Gjykatën Supreme të Kosovës si punëtor administrativ, në Spitalin e Përgjithshëm të Prishtinës dhe së fundi si editor i Shtëpisë botuese "Rozafa". Me shkrime filloi të merrej që nga bankat e shkollës fillore. Bashkëpunoi me gazetat dhe revistat në Prishtinë dhe Shkup. Shkroi poezi për fëmijë dhe të rritur, drama dhe tregime. Nga këto fusha botoi një sërë librash: "Koncerti i heshtjes" (1987), "Loja e rulletit" (1994), "Harpa e zemrës" (2011) etj. Nga krijimtaria

për fëmijë: “Zemrat bëhen ura” (2002), “Te guri i atdheut” (2006), “Kur pikëllohen zogjtë” (2007) etj. Botoi libra me tregime (“Fusha e korbave”, 2000) dhe drama (“Poshtërimi i ndjenjës”, 2007). (Hasan Hasani)

MEHMETI Rexhep (1939-1997). Kimist, profesor universiteti. Lindi në Ballnë të Kavajës, Shqipëri. Shkollimin e kreu në Mitrovicë dhe Prishtinë. Punoi mësues në Klinikë të Epërme dhe mësimdhënës në një shkollë të mesme në Mitrovicë. Studimet i kreu në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës, dega e kimisë (1966). Studimet pasuniversitare i kreu në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore (FSHMN) të Universitetit të Zagrebit, ku mbrojti edhe tezën e disertacionit (1982). Në vitin 1970 u zgjodh asistent i kimisë në FSHMN të Universitetit të Prishtinës dhe në vitet vijuese gradohet në të gjithë titujt universitarë. Ushtri funksione në institucionet e arsimit të lartë. Publikoi punime shkencore në revista dhe mori pjesë në tubime të ndryshme shkencore. Është autor i disa teksteve shkollore. (Salih Gashi)

MEHMETI Sadik (1972-). Historian, arkivist. Lindi në Kuk të Opojës. Kreu studimet në Fakultetin e Studimeve Islame në Prishtinë, studimet pasuniversitare në degën e historisë të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës, ndërsa u doktorua në fushën e shkencave historike në Universitetin e Tiranës. Nga viti 1999 punoi në Arkivin e Kosovës, kurse nga viti 2007 është pedagog i jashtëm në Fakultetin e Studimeve Islame në Prishtinë për lëndën e qytetërimit islam. Është autor dhe bashkautor i disa monografive nga fusha e historiografisë dhe e arkivistikës: “Udhërrëfyes i fondeve dhe koleksioneve arkivore” I-III” (bashkautor, 2003-2004), “Dorëshkrimet orientale në Arkivin e Kosovës” (2008), “Transkriptimi i Mevludit të Tahir ef. Popovës” bashkautor, 2008), “Rrystem ef. Shporta - jeta dhe vepra” (bashkautor, 2010), “Imamët dëshmorë në luftën e fundit në Kosovë 1989/1999” (bashkautor, 2010 etj.) “Kontribute për historinë e Opojës” (2015) dhe bashkautor i disa bibliografive. Është pjesëmarrës me kumtesa në konferenca shkencore dhe profesionale brenda dhe jashtë vendit. (Nuridin Ahmeti)

MEHMETI Shazim (1958-). Shkrimtar, piktor, mësimdhënës universiteti. Lindi në Gos-

tivar. Kreu shkollën fillore dhe të mesme në vendlindje, studimet në Fakultetin e Ndërtimtarisë në Prishtinë. U doktorua për filologji në Universitetin e Shkupit (2009). Ka botuar librat me poezi: “Drejtpehimi i humbur” (1991), “Shkallmimi i shtëpisë” (1992), “Varre dhe lumë” (1993), “Kam frikë nga lehjet” (1994), “Së besoj parajsën tënde” (1995), “Baladë për sedrën” (1998), “Lumenj që fluturojnë” (1999), “Zogj shpirti (2002)”, “Lumenjtë e dritës” (2009), “Rrëfime nga anëtejana” (2010), “Nën pemën e natës” (2011) etj. Është autor i librave me tregime: “Tullaci dhe netët me hënë” (1995) dhe “Stinë e kafshës” (2004) dhe i romanit “Trëndafili i bardhë prej reje” (2012). Ka botuar edhe disa libra me studime. Sh. Mehmeti ka hapur disa ekspozita personale me piktura dhe është fitues i disa çmimeve për letërsi dhe në shkencat e ndërtimtarisë. Shkrimet e tij letrare janë përfshirë në antologji dhe janë përkthyer në disa gjuhë. Është ligjërues në Universitetin Shtetëror të Tetovës në Fakultetin e Shkencave Aplikative. (Salajdin Salihu)

MEHMETI Shemsi (1925-2015). Gazetar, shkrimtar. Lindi në Dumnice të Podujevës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, të mesmen e nisi në Shkup, por e ndërpreu për shkak të Luftës së Dytë Botërore. Gjatë viteve 1941-42 punoi në administratën komunale të Podujevës. Më vonë punoi mësues dhe përgjegjës për arsim. Me fillimin e botimit të “Rilindjes” dhe të “Flakës së vllaznimit”, filloi të bashkëpunonte me këto gazeta. Më 1949 u punësua në gazetën “Rilindja”, ku kreu detyrën e gazetarit dhe të redaktorit për shumë vjet. Shkroi lajme, komente dhe fejtone dhe redaktoi rubrika të ndryshme. U mor edhe me letërsi. Botoi dy përmbledhje me tregime, “Kur kumbullat bajshin rrush”, “Ai e ajo” dhe romanet “Sokolat” dhe “Bijtë e tokës së djegur”. Në vitin 1996 botoi monografinë e Llapit “Të huaj në tokën e vet”. U pensionua më 1982, por bashkëpunoi me “Rilindjen” deri më 1990. U nderua me çmime dhe mirënjohje për punë shumëvjeçare në gazetari. (Zenun Çelaj)

MEHMETI Valbona (1971-). Gazetare. Punën në gazetari e filloi në vitin 1997 në gazetën e përditshme “Koha ditore”. Në vitet 1997-1999, kur shpërtheu lufta e armatosur në Kosovë, ka raportuar edhe nga zonat e luftës. Në vitin 2000 është shpallur gazetare e vitit nga

Federata e Gazetarëve të Kosovës dhe Qendra për studime humanistike “Gani Bobi”. Në vitet 2002-2012 ka punuar si redaktore, fillimisht e kulturës, pastaj e rubrikës së kryeqytetit dhe më pas redaktore përgjegjëse e gazetës. Nga viti 2012 mban postin e zëvendëskryeredaktore në gazetën “Koha ditore” dhe shkruan komente. (Nehat Islami)

MEJTEPET. Shkollë fillore fetare islame, që kryesisht funksiononte në xhami ose pranë saj. Gjatë kohës së Perandorisë Osmane ky tip i shkollave ishte i përhapur në mbarë hapësirën shqiptare. Mejtepi më i vjetër i ndërtuar si objekt i veçantë ndër shqiptarët është ai i Sinanudin Jusuf Çelebiut, i ngritur në Ohër, para vitit 1491, kurse në Kosovë mejtepi i Suzi Çelebiut nga Prizreni i ngritur më 1513, pastaj mejtepi i Kukli Beut në Opojë (1538), mejtepi i Koxha Sinan Pashës në Kaçanik (1586) etj. Mejtepe ka pasur në të gjitha qytetet e Kosovës, po edhe në shumë fshatra. Aty mësohej alfabeti, leximi i Kuranit, bazat e fesë, bukurshkrimi, kaligrafia, katër veprimet kryesore aritmetike: këndimi i kasideve, i ilahive dhe i mevludit. Përveç kësaj nxënësve u kërkohesh të lexonin fjalorë të caktuar poetikë në arabisht dhe persisht. Kuadrin mësimor në mejtepe e përbënte mësuesi (mual-lim) dhe repetitori (halife), e në mungesë të tyre këtë e bënte imami i xhamisë së mejtepit përkatës. Nëse mejtepi ishte themeluar nga njerëz bamirës, shkollimi ishte falas, sepse ata i caktonin mejtepit prona të caktuara si vakëfe, prej të cilave nxirrej rroga e mësuesve. Prej vakëfeve plotësoheshin edhe nevojat e nxënësve për ushqim dhe veshmbathje, sidomos për ata që ishin jetimë dhe të varfër. Mejtepet ishin të djemve, të vajzave dhe të përziera. Meqë shteti osman nuk ndërhynte në çështjet e mejtepeve as me përkrahje dhe as me pengesa, kjo bëri që në këto mejtepe mësuesit shqiptarë t’ua mësonin fëmijëve edhe tekstet në gjuhën amtare dhe shpjegimi i mësimi të bisedat në klasë të zhvilloheshin në gjuhën shqipe. Të tillë ishin mejtepi i Tahir Gjakovës, mejtepi i Tahir Llukës së Deçanit, mejtepi i Jonuz Efendiut nga Mitrovica, mejtepi i Tahir Popovës, mejtepi i sheh Malës së Rahovecit etj. Me reformat e vitit 1839, Porta e Lartë bëri përpjekje të mëdha për t’i mbyllur mejtepet klasike dhe në vend të tyre të hapte shkolla shtetërore fillore të reformuara, të quajtura “mejtepe iptidaije”.

Megjithatë, mbyllja e mejtepeve klasike nuk u bë, të paktën jo në masën siç parashihte qeveria osmane. Mejtepet vazhduan së funksionuari deri pas largimit të osmanëve nga hapësirat shqiptare, e në disa raste deri në fund të Luftës së Dytë Botërore. Nga viti 1945 e tutje, nëpër xhami kryesisht mësoheshin bazat dhe kushtet e fesë islame, një praktikë që vazhdon edhe sot e kësaj dite. (Resul Rexhepi, Sadik Mehmeti)

MEJZINI Halim (1984-). Grafist. Lindi në Kosovë të Sharrit. Kreu shkollën e mesme në Mitrovicë, ndërsa studimet për grafikë në Fakultetin e Arteve në Prishtinë (2007). Studimet pasuniversitare i kreu në Vjenë. Realizoi ekspozita personale në Prishtinë dhe në Vjenë dhe mori pjesë në disa ekspozita kolektive në vend dhe jashtë. Në vitin 2008 prezantoi Kosovën në Bienalen e Grafikës në Sofje, ku mori çmimin e tretë të jurisë. Përfaqësoi Kosovën edhe në vende të tjera të botës, si në Kinë, Meksikë, Spanjë etj. (Ili Muharremi)

MEJZINI Mazllom (1930-2004). Kantautor dhe instrumentist popullor. Lindi në Gjakovë në një familje që u mor me këngën dhe me ahengun gjakovar. Që i ri filloi të paraqitet si këngëtar solist në shoqëritë muzikore “Ymer Riza”, “Bajram Curri”, “Kosova” e “Hajdar Dushi”. Krijimtaria e tij përbëhet nga rreth 70 këngë, 35 prej të cilave të regjistruara në radio dhe të paraqitura në festivale. Përpos kompozimeve të veta, këndoi dhe këngë shkodrane e elbasanase. M. Mejjini i këndonte jetës, rinisë, dashurisë, figurave historike dhe natyrës. Kënga e parë e tij “Kur një ditë të pashë” i kushtohet dashurisë. Janë të njohura dhe këngët “Po të lutem me m’kujtue”, “Kur prej teje u ndava”, “Kah dera të erdha” etj. Këndonte dhe këngë me shtrirje të gjerë vokali. Ka kënduar edhe në diasporë, me Qamilin e Vogël, Ismet Pejën etj. Ka regjistruar disqe në “Jugoton” të Zagrebit, me Qamilin e Vogël dhe me SHKA “Hajdar Dushi”. (Krenar Doli)

MEJZINOLLI Osman (1947-2006). Piktur. Lindi në Shalë të Drenicës. Mbaroi shkollimin fillor e të mesëm në vendlindje dhe në Prishtinë, ndërsa studimet për pikturë në Akademinë e Arteve në Prishtinë (1978). Ishte anëtar i Shoqatës së Artistëve Figurativë të Kosovës nga viti 1978, në gjirin e së cilës ekspozoi

në shumë ekspozita të rregullta të saj, si në Sallonin Pranveror, Bienalen Ndërkombëtar të Vizatimit, në ekspozitat pranverore dhe vjeshtore. Ekspozitë vetjake pati në Pejë, Mitrovicë, Prishtinë, Prizren, Tetovë dhe në një hapësirë në Nju-Jork, ku ka prezantuar ciklin “Drama kosovare”, frymëzuar nga lufta e fundit në Kosovë. O. Mejzinolli u nda nga jeta në një aksident komunikacioni në vitin 2006 në Prishtinë. (Tahir Emra)

MEKA Alban (1976-). Piktor. Lindi në Gjakovë. Kreu shkollimin fillor e të mesëm në vendlindje, studimet për pikturë në Fakultetin e Arteve në Prishtinë (2005). Po aty kreu edhe studimet pasuniversitare. Është anëtar i Shoqatës së Artistëve Figurativë të Kosovës dhe anëtar dhe bashkëpunëtor i disa asociacioneve artistike ndërkombëtare. Hapi disa ekspozita vetjake në Gjakovë, Prishtinë, Shkup dhe Tiranë. I përzgjedhur nga Asociacionet Ndërkombëtare Artistike ekspozoi edhe në Bullgari dhe Spanjë, si dhe në Zvicër, Turqi, Brazil etj. Shquhet për nga fryma e ekspresionizmit modern. U shpërblye me çmimin e parë për pikturë në Granada (Spanjë) më 2008, në Fine Arts Internacional Context “Antonio Gualda”. (Tahir Emra)


MEKA H. Nafie (1942-). Kimiste, biokimiste, profesore universitare. Lindi në Gjakovë, shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në vendlindje, studimet për kimi në Fakultetin Filozofik në Prishtinë (1965). Kreu studimet pasuniversitare në Zagreb (1973), më pas në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë mbrojt tezën e doktoratës (1980). Në fillim u emërua mësime të kimisë dhe më 1972 u zgjodh asistente e lëndës biokimia në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë, ku arriti titullin profesor ordinar. Ishte e para femër shqiptare me titullin magjistër i shkencave nga kimia dhe doktori i dytë i shkencave nga radhët e femrave shqiptare në Kosovë. Botoi një sërë punimesh shkencore, si autore dhe bashkautore. (Lumturije Luci)

MEKAJ Hajdar (1945-). Gazetar. Lindi në Pejë, ku kreu shkollën fillore dhe të mesme, ndërsa studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe i mbaroi në Universitetin e Prishtinës. Pak kohë punoi në arsim, ndërsa nga viti 1973 ishte korrespondent i “Rilindjes” nga Peja. Pas

mbylljes së “Rilindjes” më 1990, vazhdoi të raportojë për gazetën “Bujku”. Gjatë viteve ‘90 ishte i angazhuar në Këshillin për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut në Pejë. Shkroi lajme, vështrime, reportazhe e analiza mbi zhvillimet në këtë komunë. Pas Luftës në Kosovë punoi në sektorin e kulturës në komunën e Pejës. (Zenun Çelaj)

MEKOLLI Basri (1966-). Grafist. Lindi në Podujevë. Shkollimin bazë e mori në Prishtinë, ku kreu edhe Fakultetin e Arteve. Ishte përfaqësues i Kosovës në Konferencën Ndërkombëtare të Grafikës në Projektin TEMPUS në Zagreb dhe bashkorganizator i disa ekspozitave kombëtare dhe kurator i ekspozitës “Arti kosovar” në Spanjë. Ekspozoi në Kosovë, Danimarkë, Bullgari, Gjermani, si dhe qe pjesëmarrës në disa anuale, bienale e trienale ndërkombëtare, prej nga mori çmime dhe mirënjohje, siç janë: Çmimi III i Bienales Interkontinentale “Inter-Art” Aiud, Rumania (2006); Mirënjohja e Bienales XII Ndërkombëtare, Taiqung, Tajvan (2007); dhe mirënjohjen për të arriturat në grafikë në Trienalen II të Bangkokut, Tajlandë (2009). Është autor i dy librave shkollorë: “Edukata figurative” për klasën IV dhe V të fillores. Është profesor i rregullt në Fakultetin e Arteve në Prishtinë. (Bislim Aliu)

MEKULI Esad (1916-1993). Poet, akademik, përkthyes, themelues i revistës letrare “Jeta e re”. Lindi në Plavë të Malit të Zi, gjimnazin e kreu në Pejë, fakultetin e veterinarisë në Beograd. Si



ESAD MEKULI

i ri u përfshi në lëvizje studentore përparimtare të viteve tridhjetë në Jugosllavinë e atëherëshme. Ishte pjesëmarrës aktiv në Luftën Nacionalçlirimtare, redaktor i gazetës ilegale “Liria”. Pas luftës ishte redaktor përgjegjës i gazetë “Rilindja”. Nga viti 1949 deri në pensionim ishte kryeredaktor i revistës letrare “Jeta e re”. Ishte kryetar i parë i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (1975-1979), kryeredaktor i Enciklopedisë Jugosllave për Kosovën, anëtar korrespondent i disa akademive të shkencave dhe të arteve në hapësirën e Ballkanit. Shkroi dhe botoi poezi qëkur ishte nxënës i gjimnazit

në Pejë, më pas edhe si student, në gjuhën serbe, në shumë gazeta dhe revista të viteve '30 në Beograd, Zagreb, Sarajevë. Vjershën e parë e botoi në vitin 1932. Pas luftës, në gjuhën shqipe, E. Mekuli botoi në faqet e revistë letrare "Jeta e re" dhe në gazetën "Rilindja". Vëllimi i pare poetik "Për ty" doli në dritë më 1955. Në vazhdim ai botoi edhe këta vëllime: "Dita e re" (1966), "Afsha Ada" (1971), "Vjersha" (1974), "Rini e kuqe" (1984), "Drita që nuk shuhet" (1989). Poezia e Esat Mekulit është në frymën e lirikës sociale të angazhuar, që mbizotëronte në një pjesë të Europës gjatë viteve njëzetë-tridhjetë të shek. XX. Gjithnjë në këtë frymë, ishte i angazhuar sidomos edhe për lirinë e munguar të shqiptarëve në shtetin e atëhershëm serb-kroat-sloven. Lirika e tij frymëzohet nga dashuria për vendlindjen dhe për të nesërmen e saj. Pas çlirimit ajo do të jetë entuziaste dhe optimiste për të ardhmen, por edhe e bren-gosur, ndërsa në momente edhe e zhgënjyer dhe e dëshpëruar nga pengesat që dilnin drejt këtij vizioni. Bashkë me zhgënjimin që pësonte Kosova shqiptare nga viti në vit, zyntohej dhe bëhej dëshpëruese edhe muza poetike e E. Mekulit. Përktheu nga gjuha serbokroate në shqip vepra dhe autorë nga më të rëndësishmit prej gjuhëve sllave si dhe shumë vepra dhe autorë nga shqipja në serbisht, ndër të cilët edhe Ismail Kadarenë, Anton Pashkun, Azem Shkrelin etj. (Ali Aliu)

MEKULI Gëzim (1966-). Studiues i medias. Lindi në Pejë. Shkollimin e mesëm e kreu në vendlindje, studimet në Universitetin e Prishtinës (gjuhë dhe letërsi angleze). Në Universitetin e Mainzit në Gjermani studioi shkencat politike, ndërsa në Oslo të Norvegjisë shkencat e medias dhe të komunikimit. Në vitin 2003 në Oslo themeloi agjencinë informative "Mekuli-Press", e fokusuar në marrëdhëniet e medias dhe të politikës. Në vitin 2006 botoi librin me titull "Mediet dhe politika", ku trajtohen ndikimet politike dhe ideologjike të UNMIK-ut në gazetarinë shqipe. Shkruan edhe për gazetatat norvegjeze, për tema nga Kosova dhe shqiptarët në ish-Jugosllavi. Jeton në Oslo. (Ibrahim Berisha)

MEKULI Hasan (1929-1996). Kritik letrar, profesor universiteti. Lindi në Plavë, në Mal të Zi. Kreu arsimin fillor në vendlindje, të mesmin në Shkup, Prishtinë dhe Berane, ndër-



HASAN MEKULI

sa studimet për letërsi jugosllve i mbaroi në Universitetin e Beogradit. Fillimisht ishte mësimdhënës në Normalen e Prishtinës, më pas drejtor i Teatrit Popullor Krahinor (1959) dhe nga vitit 1963 profesor në Fakultetin Filozofik të Prishtinës. Ndërkohë ishte kryetar i Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës, kryeredaktor i revistës letrare "Jeta e re" dhe drejtor i Bibliotekës Popullore dhe Universitare të Kosovës. Ushtroi edhe funksione të tjera shoqërore e kulturore. Që nga rinia e tij filloi të merrej me krijimtari letrare, kryesisht me poezi e tregime (1950) e pastaj me përkthime dhe kritikë letrare, duke shkruar për autorë dhe vepra të letërsisë shqipe, botërore dhe të letërsive të kombeve të Jugosllavisë. Shkrimin e parë nga fusha e kritikës e botoi në revistën "Jeta e re" më 1955. Punimet e tij kryesisht letrare, kulturore, eseistike, por edhe politike u botuan pothuajse në të gjitha gazetatat dhe revistat shqipe si dhe në gjuhët e tjera të hapësirës ish-jugosllave. Në tërësi botoi mbi 600 shkrime nga kritika letrare, studime, recensione etj. Pikëpamjet e tij kryesore lidhur me letërsinë gjenden në shkrimin "Letërsia dhe roli i saj shoqëruar" (1960) dhe në tekstin studimor "Rrugët e zhvillimit të letërsisë shqipe në Jugosllavi". Përgatiti antologjitë: "Panoramë e letërsisë shqipe në Jugosllavi", "Drama shqipe", "Drama të zgjedhura", "Njëaktëshe të zgjedhura", pastaj antologjinë e prozës shqipe botuar në serbisht "Trungjet" etj. Derisa ishte gjallë nuk botoi ndonjë libër autorial, por pas vdekjes u botuan dy vëllime me tekste kritike: "Romani shqiptar" (2000) dhe "Letërsi botërore-autorë dhe vepra" (2002). (Femi Cakolli)

MEKULI Sahadete (1928-2014). Mjeke, gjinekologe, obstetere, profesore universiteti. Lindi në Ohër, shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në vendlindje, kurse Fakultetin e Mjekësisë në Shkup (1953). Në vitin 1954 filloi punën si mjeke në Spitalin e Përgjithshëm në Prishtinë. Specializimin nga gjinekologjia dhe obstetrika e kreu në Fakultetin e Mjekësisë në Beograd (1960). Ishte kryeshefe e repartit të gjinekologjisë dhe obstetrikës në Spitalin e Përgjithshëm në Prishtinë (1960-1962). Në vitin 1963 u largua nga repartit dhe u dërgua kryeshefe



SAHADETE MEKULI

e dispanserisë së grave në Shtëpinë e Shëndetit po ashtu në Prishtinë. Në vitin 1968 u rikthye kryeshefe e repartit gjinekologjik-obstetrik në Spitalin e Përgjithshëm. Për arritjet në lëmin shkencor dhe profesional, në vitin 1970 mori titullin primarius. Me hapjen e Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë u emërua ligjëruese e lëndës gjinekologji-obstetrikë. Mbrojti tezën e disertacionit në Universitetin e Beogradit (1973). Ishte femra e parë doktore e shkencave mjekësore në Kosovë. Në vitet në vijim, në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë mori të gjithë titujt universitarë. Në vitin 1975, me angazhimin e S. Mekulit filloi ndërtimi i klinikës së re të gjinekologjisë, e cila përfundoi së ndërtuari në vitin 1981. Kreu edhe detyra të tjera me përgjegjësi në kuadër të Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë. Për shkaqe politike, pas demonstratave të vitit 1981, u akuzua për nacionalizëm dhe u largua nga procesi mësimor në Fakultetin e Mjekësisë. Ndaj saj u zhvillua një fushatë e egër denoncuese nga shtypi serb i Beogradit. Në tetor të vitit 1988 u nxor me dhunë nga Klinika e Gjinekologjisë dhe u dërgua në pension. Më pas punoi si vullnetare në Poliklinikën Humanitare “Nënë Tereza” në Prishtinë. Përveç doktoratës, botoi një sërë punimesh shkencore dhe profesionale brenda dhe jashtë vendit. (Isuf Dedushaj)

MEMETI Miftar (1954-). Piktore. Lindi në fshatin Rakovec të Tetovës. Shkollimin bazë e mori në Tetovë, ndërsa studimet për pikturë i kreu në Fakultetin e Arteve në Prishtinë. Punoi si mësimdhënëse i artit figurativ në disa shkolla të mesme të Tetovës. Nga viti 1995 është mësimdhënëse në Akademinë e Arteve të Universitetit të Tetovës. Veçohet ekspozita e tij “Me dashuri për Nënë Terezën” e vitit 2010 në Tiranë, pastaj në Galerinë e Arteve në Tetovë, si dhe në Bruksel. Ekspozita u realizua për nder të 100-vjetorit të lindjes së humanistes shqiptare. Këtë qasje kishte edhe ekspozita kushtuar heroit kombëtar Gjergj Kastriotit-Skenderbeut. Është fitues i çmimit të Nëntorit të shoqatës “Draudacum” në Gostivar dhe i bocetës së bronzitë nga Shoqata “Nënë Tereza-Shkupjane”. (Jëldeze Asani)

MEMISHI Isa (1959-). Filolog orientalist, përkthyes. Lindi në fshatin Raincë të Preshevës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, të mesmen në Medresenë “Alauddin” në Prishtinë. Kreu studimet për gjuhë arabe dhe orientalistikë në Prishtinë, ku më pas kreu studimet pasuniversitare dhe mbrojti tezën e doktoratës (2004). Në periudhën 2008-2011 punoi si lektor i gjuhës shqipe në Universitetin e Trakisë në Edrene, Turqi. Botoi studime dhe vepra autoriale dhe të përkthyer, në mesin e të cilave “Fjalori Arabisht-Shqip” (2014) në dy vëllime, i cili përfshin mbi 100,000 fjalë. Ishte pjesëmarrës aktiv në konferenca shkencore brenda dhe jashtë vendit. Botimet e tij lidhen kryesisht me orientalizmat, çështje të gjuhës arabe dhe të shqipes. (Jahja Hundozi)

MEMORANDUMI I AKADEMISË SË SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË SERBISË (1986). Tekst programatik i nacionalizmit serb, i publikuar nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Serbisë (ASHAS) në vitin 1986. Që me rastin e botimit, Memorandumi mori atributet e “programit strategjik të inteligjencisë serbe”, ndërsa më vonë u konsiderua “program pararendës” i shkatërrimit të Jugosllavisë dhe i luftërave të përgjakshme në Ballkan. Bazë ideore dhe politike e Memorandumit ishte “Naçertania” e Garashaninit e vitit 1844, ndërsa në hartimin e tij morën pjesë emra të njohur të inteligjencies serbe: Dobrica Qosiq, Pavle Iviq, Antonije Isaković, Radovan Samarxhiq, Dushan Kanazir, Lubisha Rakiq, Mihailo Marković etj. Ndonëse e kishte trajtuar gjendjen e popullit serb në tërë Jugosllavinë, Memorandumi e kishte vënë në shënjestër Kosovën pas vitit 1981, përkatësisht pas Kushtetutës së vitit 1974. Demonstratat e shqiptarëve të Kosovës të vitit 1981 Memorandumi i quante “agresion neofashist”, duke theksuar se në Kosovë po bëhej “gjenocid fizik, politik, ligjor dhe kulturor ndaj popullit serb”. Qëllimi përfundimtar i Memorandumit ishte suprimimi i autonomisë së krahinave, veçmas të Kosovës, e cila me Kushtetutën e vitit 1974 formalisht kishte mbetur në kuadër të Serbisë, por kishte fituar autonomi të gjerë dhe ishte bërë pjesë konstitutive e Federatës Jugosllave. Që më 1976, 10 vjet para shpalljes së Memorandumit, me të ashtuquajturin “Libër i kaltër”, edhe nga niveli shtetëor Serbia kishte kërkuar të bëhej shtet unitar, por atëherë autoriteti i Titos e kishte ndërprerë këtë proces: Serbia nuk ishte bërë siç

e kërkonin nacionalistët serbë, por as statusi i Kosovës nuk kishte avancuar më tej. Tani Memorandumi, përveç që e riaktualizonte kërkesën e kryehershme të Serbisë që ajo të funksiononte “si shtet i popullit serb në tërë territorin e vet”, përfshirë edhe dy krahinat, kishte nxjerrë publikisht edhe ambicien deri atëherë të pashprehur, që populli serb në mbarë Jugosllvinë të jetonte në një shtet unik.

Pas kritikave që iu bënë nga Komiteti Qendror i Lidhjes Komuniste të Serbisë, Memorandumi nuk u bë dokument zyrtar as i ASHAS-së e as i Serbisë. Por me kohë ai u bë bë program politik i qarqeve të caktuara brenda institucioneve të shtetit, të partisë, të policisë, të ushtrisë dhe të Kishës Ortodokse Serbe. Besohet se paraardhësi i Slobodan Milosheviqit në funksionet partiake në Serbi, Ivan Stamboliqi, u rrëzua nga pushtet pikërisht për shkak të kundërshtimit të këtij Memorandumi. Vetëm pak vite më vonë, vetë Lidhja Komuniste dhe institucionet shtetërore të Serbisë filluan t'i zbatonin pikat kryesore të Memorandumit. U fillua me propagandë agresive antishqiptare, për të vazhduar pastaj me të ashtuquajturin “revolucion antiburokratik”, që rezultoi me homogjenizimin nacionalist të popullit serb në mbarë Jugosllavinë dhe me ndryshimin e udhëheqjeve partiake në disa republika dhe në dy krahinat. (Hakif Bajrami)

MENADA E PRIZRENTIT. Shtatore miniaturë, e cila paraqet figurën e një femre në vrap. U zbulua rastësisht diku në Prizren në gjysmën e dytë të shek. XIX dhe nga viti 1876 gjendet



në Muzeun Britanik të Londrës (Fondi i Departamentit të Antikitetit Grek). Është derdhur në bronz me lartësi 11.4 cm dhe mund të ketë qenë pjesë zbukuruese e ndonjë ene të veçantë dekorative. Daton nga vitet 520-500 p.e.r. Figurina ka të veshur një hiton të shkurtër me një krahoshe, gjirin e djathtë e ka të zbuluar dhe flokët i bien të valëzuara nga prapa. Dora e djathtë i qëndron te vithet, ndërsa me të majtën mban cepin e hiotnit paksa të ngritur mbi gjurin e majtë. Ndonëse e paraqitur në vrap e sipër, kokën dhe shikimin e ka të kthyer prapa dhe kjo, me elementet e tjera, dëshmon se është fjala për Menadën, përkatësisht për Menadën dhe Satirin që i shkon pas, si grup i njohur i mitologjisë. Figurina është identike edhe me Menadën e Tetovës dhe duket të jetë artefakt i importuar nga Sparta. (Milot Berisha)

MENGJIQI Mendi (1958-). Kompozitor, mësimdhënës universiteti. Lindi në Lupç të Prishtinës. Kreu Shkollën e Mesme të Muzikës në Prishtinë, ku ndoqi dhe studimet në



MENDI MENGJIQI

Fakultetin e Arteve, drejtimi teorik-pedagogjik. Më pas studioi në degën e kompozimit (prof. Z. Ballata), që i vazhdoi dhe i kreu në Krakovë (Poloni) më 1996, bashkë me ato pasuniversitare (prof. K. Penderecki). Kompozoi vepra korale, solistike, kamerale, orkestrale, vokale-instrumentale dhe filmike. Është autor i Himnit të Republikës së Kosovës. Ndër krijimet korale janë: “Po kan çika”, për kor femrash (1987), “Dam rama dam” (1988) dhe OEIA (1991), kor i përzier; këngë për zë e piano: “Dhimbja”, “Elegjia”, “Kënga e Ylberit” (1989-1990); solistike: Cadenza, për violinë solo (1998), Canticum Festitum, për obo e organo (1998); vepra kamerale: “24” për soprano, piano e perkusion (1992), “Oh”, për soprano, klarinetë e kitarë (1992), “Metamorfoza” (1994) për violonçel, perkusion e piano; orkestrale: “Pashko Berisha”, për orkestër harqesh (1993); vepra koncertale: Koncert për obo e orkestër (1996), “Donum Musicum”, për orkestër (1997); vokalo-instrumentale: “Rondellus” për mezzo-soprano e orkestër harqesh (1994), oratoriumi “Homagium Matri Teresia” (1999). Ka kompozuar muzikën për filmat “Anatema” dhe “Gomarët e kufirit”.

Veprat e tij janë ekzekutuar nga solistë e ansamble në Kosovë, Shqipëri, Maqedoni, Austri, Finlandë, Gjermani, Poloni dhe vende të tjera. Është profesor i harmonisë në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. (Kristina Palokaj-Përkola)

MENS DORF (Mensdorff) Albert (1861-1945). Diplomati austriak, përfaqësues i Austro-Hungarisë në Konferencën e Ambasadorëve në Londër (1912-1913). Lindi në Lemberg (sot Lviv-Austri). Hyri në shërbimin diplomatik austro-hungarez në vitin 1884, fillimisht si atashe në ambasadën e Parisit dhe më pas u transferua në atë të Londrës (1889). Nga viti 1904 deri më 1914, mbajti postin e ambasadorit në Mbretërinë e Bashkuar. Përfaqësoi Austro-Hungarinë në Konferencën e Ambasadorëve në Londër. Ai mbrojti idenë e krijimit të shtetit shqiptar, fillimisht autonom e më pas të pavarur. Kërkoj me ngulm që kufijtë e Shqipërisë të përcaktoheshin sipas kriterit të kombësisë dhe në ravijëzimin në terren të kufirit të jugut të merrej parasysh kriteri etnografik dhe gjuha e folur në familje. Mbrojti fort përfshirjen e Shkodrës në shtetin shqiptar, por nuk këmbënguli në lidhje me Kosovën, e cila i kaloi Serbisë. Në vitin 1917 u emërua në Dhomën e Lartë të Parlamentit Austro-Hungarez (Herrenhaus) dhe në vitin 1920 u emërua delegat i parë i Republikës së Austrisë në Lidhjen e Kombeve. (Ledia Dushku)

MENZELZHIU Esat (1910-1969). Mësues veteran. Lindi në Dibër të Madhe, shkollën fillore e kreu në Tiranë, ndërsa normalen në Elbasan. Punën si mësues e filloi në vitin 1930 në Ostren të Peshkopisë, pastaj në Dibër të Madhe. Për shkak të veprimtarisë atdhetare, u dënua me 11 vjet burg. Pas lirimimit nga burgu, veprimtarinë arsimore e vazhdoi në fshatin Turiqec, Skënderaj. Krahas punës në shkollë u angazhua edhe për përfshirjen e femrave në shkollim dhe për emancipimin e tyre. Për kontributin e tij në arsim u dekorua me mirënjohje të veçanta, ndër të cilat edhe me çmimin “Naim Frashëri” (1993 dhe 1996), akorduar nga presidenti i Shqipërisë. (Hatixhe Vojka-Ismajli)

MEQA Jusuf (1949-). Gazetar. Lindi në Gjakovë. Shkollën fillore dhe të mesme i mbaroi në Gjakovë, ndërsa studimet për pedagogji në

Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Më 1972 u punësua gazetar në redaksinë e gazetës “Rilindja” në Prishtinë. Deri në vitin 1990, kur gazeta u mbyll nga Serbia, raportoi për zhvillimet në komunën e Prishtinës, pastaj në Universitetin e Prishtinës dhe në organizatat shoqërore-politike të Kosovës. Ka shkruar lajme, raporte, komente e analiza. Në redaksinë e gazetës ka ushtruar detyrën e redaktorit dhe të shefit të korrespondentëve. Pas luftës në Kosovë u angazhua në detyrën e redaktorit të “Rilindjes”, kurse nga viti 2002 punon si redaktor në gazetën “Kosova sot”. (Zenun Çelaj)

MEROPSËT. Kategori e popullsisë së varur në shtetin e Rashës (Serbisë). Popullsia fshatare quhej “sebr”. Pjesën më të madhe të saj e përbënin meropsët, të cilët, në diploma, hasen edhe me emrin “srbli”. Ata ishin nën vartësinë e sundimtarit, të feudalit ose të kishës. Toka që mbahej në shfrytëzim nga meropsët përbënte të ashtuquajturën “bashtina e nënshtruar”. Zotëria që gëzonte të drejtën e tokës e linte atë në shfrytëzim të meropsëve, me kusht që ta punonin dhe të kryenin obligimet ndaj tij. Sipas Kodit të Dushanit (shek. XIV), meropsi mund ta jepte tokën prikë, t’ia jepte kishës ose ta shiste, por me kusht që të punohej. Sipas Kodit të Dushanit, meropsi kryente punë angari në pronën e zotërisë së tij 106 ditë në vit, i jepte atij 1/10 e prodhimeve dhe i paguante shtetit taksë vjetore në para ose në drithë, siguronte strehim, ushqim dhe përcjellje për zotërinë e tij dhe udhëtarët zyrtarë. Kishës i paguante taksë në drithë ose në para për lidhje martesë. Pozita e meropsëve në feudet kishtare ishte më e përshtatshme, meqë ata ishin të liruar nga disa detyrime në llogari të shtetit, siç ishte ushtria. Ata ishin sinonim me parikët e Perandorisë Bizantine. Meropsët ishin të përhapur edhe në trevat arbërore, në periudhën mesjetare të sundimit të Rashës. (Qerim Dalipi)

MEROVCI Ymer (1928-). Matematikan, profesor universiteti. Lindi në Lugmir të Vushtrrisë. Shkollën fillore e kreu në Smrekonicë, maturën e vogël në gjimnazin e Prishtinës (1946), shkollën e mesme të xehetarisë në Mitrovicë e Knjazhevc (Sërbi). Diplomoi në degën e matematikës të Shkollës së Lartë Pedagogjike (SHLP) në Nish dhe më pas në drejtimin e matematikës në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore (FSHMN) të



YMER MEROVCI

Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Studimet pasuniversitare i kreu në FSHMN të Universitetit të Zagrebit (1965), ndërsa tezën e disertacionit e mbrojti në FSHMN të Universitetit të Prishtinës (UP) në vitin 1974. U zgjodh asistent në FSHMN të UP-së, ligjërues dhe profesor i rregullt. Ishte njëri ndër themeluesit e departamentit të matematikës. Ka qëndruar në vizita studimore në disa universitete të Europës dhe ka botuar një numër punimesh shkencore dhe është hartues i teksteve universitare (“Ekuacione diferenciale të zakonshme”, “Ekuacione me derivate parciale”). Është pjesëmarrës me kumtesa në shumë tubime shkencore brenda dhe jashtë vendit. (Minir Efendija)

MERXHAN Hasan (1944-2006). Shkrimtar i letërsisë turke në Kosovë. Lindi në Prizren. Qysh i ri filloi të punojë si gazetar në gazetën “Birlik” të Shkupit. Në të njëjtën kohë u bë redaktor i revistave “Sevinç” dhe “Tomurcuk”. Më vonë u vendos në Prishtinë, ku punoi në gazetën “Tan” dhe ku botoi dhe tregimet dhe poezitë. Botoi një sërë librash me krijime origjinale dhe përkthime. U shfaqën më shumë se 20 drama nga veprat e tij. Prej tyre 14 janë shfaqur në TV dhe radio. Drama “Bir Avuç Mavi (Një grusht blu)” u shfaq në vitin 1985 në Teatrin e Adoloshentëve në Londër. H. Merxhan ishte anëtar i shkrimtarëve të Jugosllavisë dhe të Kosovës. Fitoi 18 çmime për fushën e letërsisë dhe u përkthye në shumë gjuhë. 12 libra të tij u kushtohen fëmijëve. Me librin e poezive “Dayler Dayler” fitoi çmimin “Ömer Faruk Toprak”. Po ashtu më vonë në redaksinë e gazetës “Tan” u botuan veprat e tij në 10 vëllime. Para luftës në Kosovë u shpërngul në Turqi, ku vazhdoi për disa vjet krijimtarinë poetike. Vdiq në Ankara. (Irfan Morina)

MESAPISHTJA. Gjuha e mesapëve. Është një gjuhë e vdekur e familjes indoeuropiane,

e folur nga fise të pjesëve juglindore të Italisë, veçanërisht në Pulia (Puglia). Është folur nga mesapët, daunët dhe paucetët. Shumë autorë mesapishten e lidhin me ilirishten, ndërsa mesapët i shohin të shkuar atje nga Ballkani. Kjo gjuhë është ruajtur në rreth 300 mbishkrime, të cilat datojnë nga shekulli VI deri në shekullin I p.e.s. dhe janë të lexueshme, por ato zakonisht janë të shkurtra dhe nuk japin mundësi për ndonjë interpretim më të plotë të gjuhës. Janë parë afri të mesapishtes me shqipen te fragmentet si *menzana*, që lidhet me shqipen *mâz*, apo *bhilia* me *bijë*, *brention* me *bri* apo *pankekeh* me *pesë*, *aran* me *arë* etj. (Adelinë Selmani)

MESIHI Prishtinasi (1470-1512). Poet dhe kaligraf i shquar. Lindi në Prishtinë dhe u bë i njohur si Prishtinali Mesihi, sipas vendlindjes së tij. Pasi kreu studimet në Stamboll, u bë sekretar i sadriazemit Hadim Ali Pasha, gjatë kohës së sundimit të sulltan Bajazitit II (1482-1512). Në këtë detyrë mbeti deri në vitin 1511, kur Ali Pasha u vra. Mesihi la pas vetes një divan dhe konsiderohet si një nga lirikët më të mëdhenj të letërsisë së divanit. Shkroi edhe veprën humoristike “Kontrasti i qytetit”, e cila konsiderohet vepra e parë e këtij zhanri në letërsinë turke. Famën më të madhe e fitoi me vjershën “Kënga e pranverës”, e cila është vjersha e vetme e poezisë turke që hyri në antologjitë e poezisë botërore, duke u përkthyer gjatë shekujve vijues në disa gjuhë të njohura europiane, madje edhe në latinisht. Vdiq në Bosnjë. (Irfan Morina)

MESOZOIKU. Erë e historisë gjeologjike e Tokës, që përfshin periudhën ndërmjet paleozoikut dhe kenozoikut dhe që ka zgjatur rreth 186 milionë vjet, gjatë së cilës janë formuar shkëmbinjtë që përbëjnë eratemën mesozoik. Ndahet në periudhat (sistemet): trias, jurasik e kretak. Mesozoiku shquhet nga hapja e oqeanit Tetis në fillim dhe atij Atlantik nga mbarimi i epokës, nga veprimtaria e gjerë magmatike, nga malformimi, rrudhosjet dhe zhvendosjet e shumta tektonike, nga rrudhosja kimerike dhe, në fund të mesozoikut, nga rrudhosja alpine. Është periudhë gjatë së cilës fauna botërore ka ndryshuar në mënyrë drastike, nga ajo që ishte në paleozoik. Zhduken organizmat e paleozoit, para së gjithash trilobitet dhe graptolitet, ndërsa paraqiten forma të reja, siç janë:

amonitet, organizmat gjigantë të zvarranikëve (dinozaurëve), rudistëve etj., si dhe zogjtë e parë. Nga flora vend të veçantë kanë bimët mbizotëruese farëzhveshura dhe farëveshura. Gjatë mesozoit pjesa më e madhe e territorit të Kosovës mbulohej nga deti përgjithësisht i thellë e vende-vende më i cekët. U formuan në fillim shkëmbinj sedimentarë terrigjenë dhe shkëmbinj strallorë e më vonë shkëmbinj karbonatikë, sidomos gëlqerorë e dolomitë të triasikut (Bjeshkët e Nemuna, Pashtriku, Koritniku), hapja e oqeanit Jurasik dhe formimi i ofioliteve (zona e Mirditës, Vardarit). Krijimet e moshës mesozoike në Kosovë kanë përhapje relativisht të madhe dhe përfaqësohen nga gëlqerorët dhe dolomitët (Bjeshkët e Nemuna, Koritniku, Pashtriku etj.), ofiolitët (masivi i Gjakovës, i Rahovecit e Goleshit) dhe flishit (Drenicë, Carrallevë, Moravë e Binçës etj.). (Gani Maliqi)

MESTANI Nuridin (1956-). Agronom, profesor universiteti. Lindi në Kuklibeg të Dragashit. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, atë të mesme në Prizren (1976), Fakultetin e Bujqësisë në Prishtinë (1980). Studimet pas-universitare i përfundoi në Universitetin e Zagrebit (1985), tezën e disertacionit e mbrojti në Fakultetin e Bujqësisë të Universitetit të Prishtinës (1996). Punësohet në Institutin e Blegtorisë dhe të Veterinarisë në Prishtinë (1981) dhe më vonë u zgjodh asistent (1985) në Fakultetin e Bujqësisë, ku i arrin të gjitha gradat universitare. Ligjëron disa lëndë: teknologjia e rritjes dhe prodhimit të shpendëve, shkenca e shpendëve dhe fiziologjia e të ushqyerit të shpendëve. Botoi punime dhe mori pjesë me kumtesa në tubime shkencore. (Ragip Kastrati)

METAJ Kadri (1954-). Filozof, profesor universiteti. Lindi në Kaliçan, komuna e Istogut. Shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në Istog, ndërsa studimet në katedrën filozofi-sociologji në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës (UP) në vitin 1977. Magjistraturën e mbaroi në Universitetin e Sarajevës. Në vitin shkollor 1981/82 qëndroi për specializim në Universitetin e Sorbonës, Paris IV, në Francë. Në vitin 1987 doktoroi në Universitetin e Prishtinës. Në vitin 1979 zgjidhet asistent në degën filozofi-sociologji, kurse që nga viti 1999 është profesor i rregullt në departamentin e filozofisë, ku ligjëron lëndë nga fushat e

filozofisë. Ligjëron edhe në Universitetin e Europës Juglindore në Tetovë, në Universitetin e Shkupit dhe në Universitetin e Tetovës etj. Nga veprat e botuara veçohen: "Teoria estetike e Gjergj Llukaçit" (1990), "Filozofia politike" (2003). Përktheu disa veprave nga fusha e filozofisë dhe e estetikës. (Albulena Alushaj)

METAJ Rrustem (1953-). Balerin. Lindi në Kaliçan të Pejës. Kreu shkollën e mesme të baletit në Shkup. Mori pjesë në këto shfaqje: "Ritme të zgjuara", "Paralojë dasme", "Sokoli e Mirusha", "Halili e Hajrija", "Bolero dhe Shtrausiana", "Karmen", "Era dhe kolona", "Balloja e kadetëve", "Don Kishoti", "E bukura More", "Pjetër Pani", "Loja e Sizifit" dhe "Fyelltari". (Selman Jusufi)

METALURGJIA E PLUMBIT E "TREPÇËS", MITROVICË. Zhvillimi i metalurgjisë së plumbit (Pb) në "Trepçë" filloi në vitin 1940 kur u ndërtua shkretorja në Zveçan, me aftësi prodhuese prej 28,000 tonë plumb lëndor në vit. Kushtet e punës të kësaj shkretoreje ishin të rënda, prandaj e quajtën "Shkretorja për prodhimin e invalidëve". Pas Luftës së Dytë Botërore, në kohëra të ndryshme (faza e parë 1950, faza e dytë 1967 dhe faza e tretë 1982) janë bërë rikonstruktione dhe zgjerime tekniko-teknologjike të shkretores së plumbit, me qëllim të shtimit të prodhimit: në fazën e parë 50-60,000 tonë Pb lëndor në vit, në fazën e dytë në 80-90,000 t/v dhe në të tretën ishte projektuar aftësia maksimale prodhuese prej 175,000 t/v Pb lëndor, përkatësisht në fillim të fazës së tretë 120,000 t/v Pb. Ndërkaq, prodhimi më i lartë pas rikonstruktimit (1967) arriti në vitin 1975, në sasi prej 106,859 tonë. Shkretorja e Pb e "Trepçës" radhitej ndër 5 shkretoret më të mëdha në botë. Në Metalurgjinë e Pb "Trepça" përpunoheshin jo vetëm koncentratet e grup-minierave në kuadër të kombinatit (9 syresh), por edhe sasi të tjera të koncentrateve nga minierat në Serbi, Mal të Zi, Maqedoni dhe Bosnjë e Hercegovinë. Kështu, në vitin 1988 prodhoheshin këto sasi të koncentrateve: koncentratet nga minierat në kuadër të "Trepçës" 46.1%, koncentratet nga minierat e tjera të Jugosllavisë 35.1%, koncentratet nga importi 3.4% dhe nga lëndët dytësore 14.6%. Shfrytëzimi i aftësisë së projektuar të Shkretores së Pb luhatej nga 49.4% (1982) deri në 79.2%, përkatësisht 59.26-95%. Në Shkretoren e Pb të

“Trepçës” prodhoheshin 5 lloje të metaleve, me lartësi mesatare vjetore: Pb (100,000 t), Ag (120 t), Au (255 kg), Bi (96 t) dhe Sb (310 tonë të kohëpaskohshme). Xeheroret e Pb-Zn, për nga natyra janë polimetalore, pasi përveç përbërësve themelore të Pb dhe Zn përmbajnë edhe metale e elemente të tjera, si: Ag, Au, Bi, Sb, Cd, Cu, Mn, In, Ge, Te, Ta, Se dhe S. Nga të gjitha metalet dhe elementet e mësipërme, në “Trepçë” përftoheshin vetëm 7 metale, pasi “Trepça” nuk kishte teknologji për përftimin e metaleve të rralla (In, Ge, Te, Ta, Se). Kushtet e punës në metalurgjinë e Pb ishin jashtëzakonisht të rënda, për shkak faktorëve të dëmshëm që shfaqen në këtë proces dhe të ndotësve specifike kimike, në radhë të parë Pb, pastaj As, Sb, Cd, Hg dhe metale të tjera të rënda për shkak të përmbajtjes së lartë të dioksidit të squfurit. Punëtorët u ekspozoheshin efekteve të dëmshme të këtyre faktorëve. Pas vitit 1999 Metalurgjia e Plumbit e “Trepçës” u administrua nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit. (Minir Dushi)

METALURGJIA E ZINKUT E “TREPÇËS”, MITROVICË. Me lëshimin në punë të elektrolizës së zinkut (Zn) në Mitrovicë (1968) u arrit tërësia teknologjike e përpunimit



SHKRITORJA E ZINKUT NË TREPÇË

të koncentrateve në sistemin e “Trepçës”. Objekti u ndërtua me teknologjinë më të lartë të avancuar të kohës. Aftësia prodhuese e elektrolizës ishte 30,000 tonë zink elektrolitik

në vit dhe 80 tonë kadmium elektrolitik në vit. Përveç Zn dhe Cd elektrolitik, në këtë elektrolizë prodhoheshin edhe lym bakri dhe lym plumb-zinku. Koncentrati i zinkut për elektrolizën sigurohej nga minierat e “Trepçës”, të cilat siguronin vetëm 73% të sasisë së nevojshme të koncentratit të zinkut, ndërsa sasia tjetër nga minierat e tjera të ish-Jugosllavisë. Në kohën e ndërtimit të elektrolizës së Zn, shkalla më e lartë e rikuperimit të Zn në botë ishte 83%. Por më vonë, për shkak të zhvillimit të shpejtë të teknologjisë në Europë, Amerikë dhe Australi shkalla e rikuperimit të metalit të Zn u ngrit deri në 98% (Franca). Prandaj elektroliza e saponduar brenda një dekade u konsiderua e vjetruar. Për shkak të vjetërsisë jo vetëm që ra prodhimi vjetor në 13.393 tonë (1985), por njëkohësisht u rrit harxhimi i energjisë dhe i materialeve të tjera, sikundër që kishte edhe ndërprerje të shpeshta e të papritura të punës. Përveç kësaj, ndotja e mjedisit nga elektroliza shkante tej çdo mase. Kjo situatë zgjati deri në vitin 1975 kur filloi puna për studimin e një koncepti të ri për rikonstruktimin dhe zgjerimin e elektrolizës së zinkut sipas të arriturave më të reja teknologjike në botë. Atëbotë ekspertët e “Trepçës” u përcaktuan për teknologjinë e firmës “Jarosite”, e cila kreu rikonstruktimin dhe zgjerimin e elektrolizës me aftësi prodhuese të projektuar prej 80,000 tonë zink në vit. Mirëpo, për shkak të mungesës së fondeve, aftësia e projektuar nuk u përmbush në tërë procedimin teknologjik. Në vitin 1986 u përrua elektroliza e re, me aftësi prodhuese deri në 50,000 tonë. Shkalla e rikuperimit të Zn në elektrolizën e re u ngrit në 90%, kurse harxhimi i energjisë elektrike ishte 30% më i vogël dhe ndërprerjet në punë ishin pakësuar dukshëm. Pas arritjes së aftësisë së projektuar, elektroliza e re jepte këto prodhime: 80,000 t/v Zn elektrolit; 5,000 t/v oksid Zn dhe Zn pluhur; 100,000 t/v H_2SO_4 ; 368 t/v Cd elektrolit dhe 15,000 t/v lym të Pb-Zn dhe 250 t/v lym Cu. Ky objekt administrohet nga Agjencia Kosovare e Privatizimit dhe gjendet jashtë funksionimit. (Minir Dushi)

METALLA ULPIANA. Monedhë lokale e destinuar vetëm për përdorim në qendrat e minierave. U pre në kohën e perandorit Trajan (98-117). Nga disa studiues prerja e saj i është atribuar Municipium Ulpianës, ndërsa disa të tjerë e lidhin me kompleksin e minierave

në Kosmaj (Bosnjë dhe Hercegovinë), nga ku vjen dhe numri më i madh i gjetjeve. Duke pasur parasysh faktin se asnjë ekzemplar i tillë nuk është gjetur deri më tani në Ulpianë dhe rrethinat e saj, është dhe jo aq e sigurt që në rrethanat e tanishme prerja e saj të lidhet vetëm me Ulpianën. (Arben Hajdari)

METALLI DARDANICI. Monedha me mbishkrim të periudhës romake. Monedhat janë gjetur në Municipiumin DD te Sočanica (Mitrovicë) dhe të gjitha janë farkuar gjatë sundimit



të perandorit Trajan, andaj dhe në avers mbajnë bustin e perandorit me kurorë, të kthyer në të djathtë. Këto i takojnë fazave të ndryshme të sundimit të Trajanit, njëra është krijuar para vitit 98, kur Trajani ishte

vetëm "augustus"; tjetra kur fitoi titullin "germanicus" (98-100) apo "germ dac", pas pushtimit të Dakisë. Karakteristikë e monedhave është se në revers gjendet mbishkrimi "Dardanicus" dhe figura e femrës që mban kallirin e grurit me dorën e djathtë dhe me të majtën cepin e tunikës së gjatë (hitonit). Për dallim nga reverset me bustin e Trajanit, në Muzeu Britanik të Londrës gjenden tri monedha, të cilat në revers mbajnë mbishkrimin "dardanicus" dhe kanë paraqitjen e së njëjtës hyjneshe. Këto dallojnë nga monedhat paraprake vetëm nga fakti se në avers gjendet mbishkrimi "Roma" dhe koka e femrës me përkrenare (hyjnesha Roma). Pasi figura e femrës në avers ka simbole dhe paraqitje jo të zakonshme, u pa vetëm nga H. Cohen si Hyjneshë e Dardanisë, ndërsa studiuesit e tjerë e panë si hyjneshë me prejardhje të ndryshme (Rah, Annona, Abundantia, Cerera). Më së shpeshti u konsideru si Cerera romake dhe Demetra helene, të cilat mbajnë kallirin e grurit, por Demetra paraqitet gjithnjë e ulur, përderisa Cerera mban me dorën e djathtë skeptrin. Elementet dalluese nga hyjneshat e cekura sjellin në përfundim se është fjala për një hyjneshë të vendit, të identifikuar si Hyjnesha Dardane. Kjo hyjneshë nuk është vetëm personifikim i territorit të Dardanisë, por ngërthen në vete edhe funksione më gjithëpërfshirëse.

Dukja e këtyre monedhave, si edhe të tjerave, lidhet me pasurinë minerale të rajonit të

Municipium D Dardanorum-it dhe me aktivitetet me vlera të mëdha xehetare në të dhe jashtë saj, aq më tepër që aktivitetet xehetare dardane janë njohur edhe më herët dhe se është e njohur se xehetarët dardanë vepronin edhe në rajone të tjera, si në xeheroret e Dakisë etj. (Edi Shukriu)

METOHIA. Emërtim serb për pronat kishtare, i ngritur në nivel të emërtimit të rajonit të Dukagjinit, përkatësisht Rrafshit të Dukagjinit, pas pushtimit të Kosovës nga Serbia më 1912. Për filologët ballkanologë është i njohur fakti që fjala serbe kishtare *metohija* ("tokë në pronësi të manastirit" ose "territor i pronave të kishës") është huazuar nga greqishtja mesjetare (bizantine). Me këtë emër emërtoheshin shumë katunde e rajone, përkatësisht feude dhe vendbanime të veçanta, po aq sa kishte edhe manastire dhe prona të tyre. Në tekstet kishtare serbe përmenden "metohijat" e Kishës së Shmitrit në Prizren (1309-1313), pastaj të Deçanit (1330), të Dobrushtës dhe të Hoçës (1355) dhe disa të tjera. Pas pushtimit të Kosovës, me këtë emërtim kishtar pushteti serb e emërtoi krahinën që shqiptarët tradicionalisht e quanin Rrafsh i Dukagjinit, që rrjedh nga emri i derës feudale arbërore të Dukagjinëve dhe kryeqendra e saj *Gjytetja e Re* ose *Dukagjina*, përkatësisht *Civitas noua, sine Ducagina; Città noua o Ducagini, Gjytetja e rë, oò Dukagjin*, të cilën Frang Bardhi e përmend në vitin 1636. (Skënder Gashi)

MEVLUDI. Manifestim fetar islam. Mevludi është krijimtari e veçantë letrare, që i takon llojit të poemës epiko-lirike, ndërsa strukturën e tij kompozicionale zakonisht e përbëjnë pesë elemente kryesore, që janë: lindja e Pejgamberit, Miraxhi, Haxhi lamtumirës dhe vdekja e tij. Format e krijimtarisë letrare kushtuar Pejgamberit në letërsinë me temë islame janë nga më të ndryshmet, duke filluar nga distiku, kasidja, rubajja, divani e deri te veprat e posaçme që te ne njihen si mevlude. Zanafilla e Mevludit në botën islame, si manifestim fetar, daton nga shekulli X, fillimisht në Egjipt, gjatë kohës së sundimit të Fatiminjve. Në Perandorinë Osmane Mevludi merr një formë dhe trajtë tjetër, sidomos me Mevludin e autorit të njohur Sulejman Çelebiu (1409), që konsiderohet vepër me vlerë të veçantë letrare dhe kulturore. Mevludi në letërsinë shqipe si krijimtari artistike e letrare zë fill në shekullit XVIII, me

Hasan Zyko Kamberin. Deri tani në gjuhën shqipe njihen rreth 30 mevlude të shkruara nga personalitete të njohura të teologjisë islame, nga të cilët veçojmë: Hasan Zyko Kamberin, Ismail Floqin, Hafiz Ali Ulqinakun, Hafiz Ali Korçën, Hafiz Ibrahim Dalliu, Tahir efendi Popovën etj. Mevludet kanë pasur shtrirje dhe ndikim të madh në vendet ku janë hartuar. Kështu, Mevludi i Tahir efendi Popovës ka pasur dhe ka shtrirje dhe ndikim më të madh në territorin e Kosovës dhe në një pjesë të Maqedonisë. Tahir efendi Mevludin e tij e ka shkruar me grafi osmane, por me fjalë të renditura në bejte, duke respektuar në gjuhën shqipe rimën dhe metrikën e kësaj gjinie. (Ramadan Shkodra)

MEXHITI Bashkim (1965-). Pikturor, skulptor. Lindi në Gostivar. Shkollimin bazë e kreu në Gostivar, ndërsa Akademinë në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës (1991). Në vitet '90 u zgjodhë mësimdhës në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Tetovës. I takon brezit të mesëm të krijuesve të arteve pamore në Maqedoni dhe shquhet për trajtimin e motiveve autoktone. Dallohen tri cikle të pikturave të tij: "Gjurmët", "Fragmentet" dhe "Fenomenet historike". Realizoi disa ekspozita personale si dhe mori pjesë në ekspozita kolektive në Maqedoni dhe jashtë saj. Realizoi shtatoren e Xhemë Gostivarit, shtatoren e Aqif Reçanit, si dhe disa vepra të tjera skulpturore. Është fitues i disa çmimeve profesionale dhe mirënjohjeve publike. (Jëlldeze Asani)

MEZIA (MOESIA). Provincë e Perandorisë Romake. Dardania u përfshi brenda provincës së Mezisë gjatë sundimit të perandorit Klaud (41-54). Më parë Dardania ishte pjesë e provincës së Maqedonisë dhe jo e provincës së Ilirikut. Në vitin 86 Mezia u sulmua nga mbreti i dakëve, Duras dhe në mbrojtje të saj erdhi vetë perandori Domitian (81-96). Dardania, që i kundërshtoi me shekuj pushtimet romake, shërbeu disa dekada si bazë e sulmeve të legjioneve romake kundër dakëve. Por Domitiani nuk arriti fitore të sigurt kur i dërgoi legjionet përtej Danubit, kundër mbretit dak Decebalit në vitet 87-89 dhe kjo u arrit vetëm gjatë sundimit të perandorit Trajan, i cili e nënshtroi përfundimisht Dakinë gjatë luftimeve të viteve 101-106.

Dardania kishte një rëndësi strategjike veçanërisht për minierat dhe për rrugët. Andaj u

ndërtuan rrugë që lidhnin provincat e ndryshme të Perandorisë Romake, në funksion të lëvizjes më të lehtë të legjioneve dhe të mallrave. Rruga më e rëndësishme nisej nga Shkodra nëpër luginën e Drinit dhe futej në Dardani nëpër Drinin e Bardhë, duke i pasur stacionet në Gabuleo, Therandë, Viciano (Lipjan), Veklan (te Prishtina), Vendenis (Gllamnik), Ad Fines (Kurshumlje), Hammeo (Prokuplje), Ad Herkulem (Brestovc) dhe Nais (Nish). Në Viciano ndahej rruga që shkonte drejt kolonisë Scupi (Shkupi), duke kaluar afërsisht përgjatë trasesë së sotme, përmes grykës së Kaçanikut. Rruga tjetër që nisej nga Sirmi e përshkonte Dardaninë në pjesën verilindore, duke kaluar nga Nishi në Remisiana (Bela Palanka), Turribus (Piro) etj. Nais ishte një stacion kryesor i rrugëve që shkonin drejt Danubit dhe vendosja e legjionarëve romakë, veçanërisht e atyre të Legjionit VII Claudia gjatë sundimit të Septim Severit, bëri që në qytet të zotëronte elementi latin. Jo larg Naisit, përgjatë rrugës, u zhvilluan dy vendbanime të legjionarëve veteranë: Timaku i Madh dhe Timaku i Vogël. Me ndarjen e Mezisë në Mezinë e Epërme dhe në Mezinë e Poshtme në vitin 86, Dardania u bë pjesë e Mezisë së Epërme. (Neritan Ceka)

MEZIA E EPËRME (MOESIA SUPERIOR). Provincë e Perandorisë Romake. Pas përfshirjes së Dardanisë brenda provincës së Mezisë gjatë sundimit të perandorit Klaud (41-54) dhe pas ndarjes së saj në dy pjesë në vitin 87 (Mezia e Epërme dhe Mezia e Poshtme), Dardania u bë pjesë e Mezisë së Epërme të qeverisur nga legati konsullor perandorak dhe prokuratori. Provinca përfshinte pjesën më të madhe të Dardanisë, me qendër kryesisht Naisin. Autori Zonara (X 32) njofton se në Mezinë e Epërme përfshiheshin popullsi të ndryshme: "ato vende që gjenden mbi Dalmati, Maqedoni e Traki dhe që lumi Sava, i cili derdhet në Istër, i ndan nga Panonia, kaluan nën emrin e Mezisë. Në këto vende ka edhe shumë fise të tjera, si dhe të quajturit tribalë dhe dardanë".

Dardania njihet që më parë për aktivitetet xehetare, andaj në gjysmën e parë të shek. II komunitetet xehetare të saj fituan të drejtën e prerjes së monedhave prej bronzi me emrat e perandorëve Trajan dhe Hadrian. Këto monedha mbanin legjendat "Metalla Ulpiana" dhe "Dardanici". Për kontrollin e minierave ishin caktuar punonjës të veçantë, të njohur

edhe më pas si administratorë perandorakë për minierat në Mezi ose Dardani (procuratores metallorum intra Moesiam seu Dardaniam). Megjithë prezencën e ardhësve latinë, popullsia dardane dallohej nga emrat tipikë edhe ndërmjet legjionarëve, si Bitus, Mastul, Daz, Saur, Mestri, Muko, Auluzon etj. Shumë nga këta emra, si Gent, Redon, Bato etj., i takojnë fondit panilir të onomastikës, por pjesa më e madhe e tyre i takojnë vetëm fondit onomastik dardan. Dy kohorta, të krijuara në vitin 169 nga perandori Mark Aureli mbanin emrin Aurelia Dardanorum, të cilat ishin dislokuar në Timacus Maior dhe Timacus Minor. Dardanët u mobilizuan edhe në repartet ushtarake të rekrutuara në Dardani gjatë shek. I-II, si Ala Vespasiana Dardanorum, Legio I Illyricum. Në Nais kishte qendrën edhe komandanti i ushtrisë për Ilirikun (magister militum per Illyricum), që dëshmon rëndësinë strategjike të trevës dardane.

Gjatë sundimit të Hadrianit iu dha e drejta e municipit edhe Ulpianës (Graçanicë), qendër administrative në funksion të minierave. Qyteti u shtri në një sipërfaqe prej rreth 100 ha të organizuar sipas një sistemi ortogonal, me rrugë e kanalizime të rregullta dhe kishte një forum me monumente të veshura me mermer. Kjo u shoqërua me vendosjen e administratës provinciale, si dhe të legjioneve, për shkak të pozitës strategjike të provincës: Legjioni IV Skit (deri më 57), Legjioni V Maqedon (deri më 62), i zëvendësuar nga Legjioni VII i Klauëve dhe Legjio IV i Flavëve gjatë sundimit të dinastisë Flave (69-96). Municipi i rëndësishëm xehetar ishte dhe ai që njihet nga inicialet DD pranë Soçanicës (Mitrovicë), që mendohet se mund të zëbërthet si "municipium Dardanorum". Scupi (Shkupi) ishte qendër tejet e rëndësishme e Dardanisë, ku ishin vendosur veteranë të shumtë të legjioneve romake, andaj dhe fitoi të drejtën e kolonisë. Në Kosovë kishte dhe municipiume të tjera, emrat e të cilave nuk janë dëshmuar ende, si ajo te Dërsniku, Gushica etj. Nga mbishkrimet epigrafike njihen edhe fshatrat (vicus), si Titis, Zatidis, Perdica, Dassa apo Cavadinus, pranë kolonisë së Scupit. Dardania ngeli pjesë e Mezisë së Epërme deri në krijimin e provincës së Dardanisë nga perandori Dioklecian (284-305), me qendrën më të rëndësishme në Scupi. Arsye për krijimin e provincës së veçantë ishte elementi etnik, humbja e zotërimeve përtej

Danubit në kohën e perandorit Aurelian dhe vendosja e fiseve barbare në Danub, me ç'rast Dardania fitoi rëndësi të veçantë strategjike për bllokimin e dyndjeve barbare drejt Adriatikut dhe Egjeut. (Neritan Ceka)

MEZIER Filip de (Mezieres Philippe de) (rreth 1327-1405). Ushtarak dhe udhëpërshkrues francez. Lindi në Shato de Mezier në krahinën Pikardi në Francën Veriore. Rridhte nga fisnikëria e ulët franceze dhe fillimisht shërbeu si ushtarak në oborret e aristokracisë italiane. Nga Italia u bashkua me kryqtarët dhe mori pjesë në mbrojtjen e Smirnës (Izmiri), kundër forcave osmane në vitin 1346. Pas shpërndarjes së forcave kryqtare, ai vazhdoi udhëtimin për në Jerusalem. Më vonë Mezier zë postin e administratorit dhe ushtarakut në Qipro dhe u kushtohet shkrimeve. Në veprën "Ëndrra e pelegrinit të moçëm" (*Le Songe du vieil pèlerin*), të shkruar në vitin 1389, Mezier bën fjalë për një betejë që ishte zhvilluar në pjesët e Arbërisë dhe që aludohet për Betejën e Parë të Kosovës. Mes tjerash, lidhur me këtë betejë ai thoshte se "Murati u mposht plotësisht nga të krishterët" dhe se ngjarja u zhvillua në "pjesët e Arbërisë". F. Mezieri la të shkruara edhe vepra të tjera: "Jeta e Shën Pjetër Tomasit" (1367-68, plotësuar më 1386 e 1396), "Religjioni i ri i pasionit" (1389) etj. (Muhamet Mala)

MEZISHTJA. Gjuhë e popullatës që jetonte në jug të Danubit, në Serbinë e sotme dhe pjesërisht në Bullgari dhe Rumani deri te delta jugore e Danubit. Në kohët e vona romake ishte krijuar Provinca Moesia Superior në perëndim dhe Moesia Inferior në lindje. Mendohet se mezishtja ishte një gjuhë me lidhje shumë më të afërta me dakishten se me trakishten, pra një gjuhë më shumë dako-mezishte se trakomezishte. Disa të tjerë e shohin si një me dakishten. Nuk është shkruar dhe njihet vetëm nga emrat e vendeve a të ujërave. (Adelinë Selmani)

MËSIMDHËNËSIT NGA SHQIPERIA NË KOSOVË. Mësimdhënësit me prejardhje nga Shqipëria zënë një vend të rëndësishëm në historinë e themelimit dhe zhvillimit të arsimit shqip në Kosovë. Ndihtesë të çmuar dhanë edhe mësimdhënësit nga Kosova në Shqipëri, si Qamil Bala, Sali Gjuka, Ahmet Gashi etj. Nga Shkodra ishte Mati Logoreci, i cili hapi

shkollën e parë kombëtare shqipe në Kosovë (Prizren, 1889), si dhe motrat Mikelangjela dhe Tereza Çoba, mësueset e shkollës shqipe të vajzave po në Prizren. Kjo ndërlihdje në fushën e arsimit do të vazhdojë edhe më vonë, gjatë Luftës së Parë Botërore (1915-1918), sidomos gjatë Luftës së Dytë Botërore (1941-1945). Duke filluar nga viti 1941, Qeveria Shqiptare dërgoi në Kosovë më shumë se 200 mësues dhe mësuese, inspektorë, drejtorë etj., për themelimin e shkollave dhe arsimit shqip, si pjesë integrale e sistemit të arsimit në Shqipërinë Etnike. Kontribut të veçantë në këtë drejtim dha ministri i arsimit shqiptar, Ernest Koliqi. Këta mësues nga Shqipëria, në bashkëpunim me mësuesit dhe popullsinë vendase, bënë punë të jashtëzakonshme për gjuhën shqipe, arsimin dhe kulturën kombëtare shqiptare në Kosovë. Me ndihmën e tyre, për herë të parë në Kosovë, u ngrit një sistem i arsimit me shkolla fillore, të mesme dhe profesionale shqipe. Mësimdhënësit nga Shqipëria dhanë kontribut të çmuar edhe në ngritjen profesionale-pedagogjike të mësuesve në Kosovë. Edhe pas Luftës së Dytë Botërore, Shqipëria u angazhua për shkollat dhe arsimin shqip në Kosovë. Sipas marrëveshjes shqiptaro-jugosllave (1945), Shqipëria dërgoi në Kosovë rreth 100 mësues, të cilët punuan në arsimin kosovar deri nga mesi i vitit 1948, kur për shkaqe politike u detyruan të kthehen në Shqipëri. Disa prej tyre vazhduan punën edhe më vonë. Midis mësimdhënësve nga Shqipëria, që dhanë kontribut në Kosovë edhe pas vitit 1948, u shquan: Mehmet Gjevori, Tajar Hatipi, Stathi Kostari, Fehmi Sinella etj. Mësimdhënësit nga Shqipëria dhanë ndihmesën e tyre edhe në arsimin e lartë kosovar. Kjo u intensifikua sidomos në vitet 1978-1981. Në atë kohë pedagogë të shquar të Universitetit të Tiranës u angazhuan për të ligjëruar dhe në aktivitete të tjera mësimore-shkencore në fakultete të Universitetit të Prishtinës. (Hajrullah Koliqi)

MIFTARI Daim (1979-). Poet, gazetar. Lindi në Sërmnovë të Gostivarit, ku kreu shkollimin fillor dhe të mesëm. Në vitin 2004 kreu studimet në degën e gjuhës dhe letërsisë shqipe në Fakultetin e Filologjisë në Shkup, ku mbaroi edhe studimet pasuniversitare. Në periudhën 2004- 2007 punoi gazetar në gazetën "Fakti", më pas mësimdhënës në shkollë të mesme dhe së fundi nëpunës shtetëror në Qeverinë

e Maqedonisë. Ka botuar librat me poezi: "Tingujt e heshtjes" (2007), "As ëndrra për nesër" (2010) dhe "Vetëm" (2013). Një libër i tij është botuar edhe në gjuhën maqedonase. (Salajdin Salihu)

MIFTARI Kaltrina (1989-). Soprano. U diplomua në drejtimin e solokëndimit në klasën e prof. Merita Junikut, në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. Është anëtare e rregullt dhe soliste në Korin e Filarmonisë së Kosovës. Qysh si studente ka marrë pjesë në shumë gara ndërkombëtare në Prishtinë, Shkup dhe Tiranë, ku është nderuar me çmime të para dhe të dyta. Është një nga pionieret e interpretimit të muzikës së vjetër të periudhave të renesansës e të barokut dhe shquhet për përkushtimin ndaj këtyre stileve. (Besa Luzha)

MIFTARI Naser (1974-). Gazetar. Lindi në Prishtinë, ku edhe kreu shkollën fillore dhe të mesme. Gjatë viteve 1993-1997 ndoqi studimet për gazetari në Universitetin e Tiranës dhe më pas (2000-2002) studimet master në Universitetin "Temple" në Filadelfia, SHBA. Në vitin 2014 përfundoi studimet e doktoraturës në departamentin e shkencave politike të Universitetit të Nebraskës në Linkoln (Lincoln), SHBA. Punoi gazetar, columnist dhe redaktor në gazetën "Koha ditore" dhe ligjëroi në disa universitete për gazetari dhe komunikime publike. Botoi një varg punimesh shkencore nga fusha e komunikimit dhe e shkencave politike, përfshirë një kapitull mbi bllokadat demokratike në Ballkan në librin "Kultura, katastrofat dhe retorika" (Nju-Jork, Oksford, 2015) dhe një kapitull mbi pavarësinë e institucioneve në Kosovë në librin me titull: "Roli i ndihmës ndërkombëtare në zhvillimin e institucioneve të medias në Ballkanin Perëndimor" (Budapest, 2016). (Artan Krasniqi)

MIFTARI Vehbi (197-). Lindi në Dumnicë të Vushtrrisë. U shkollua për letërsi në Prishtinë. Më 2009 u doktorua në Universitetin e Prishtinës me temën për kritikën letrare shqipe. Punoi si gazetar dhe redaktor i kulturës, kryeredaktor i revistës për kulturë, art e letërsi, "Fjala" (2004). Ishte mësimdhënës në Universitetin e Prizrenit dhe në Universitetin e Pejës. Disa nga librat e V. Miftarit janë: "Mëngjes në pasqyrë" (poezi, 1995), "Figura në rërë" (poezi, 2000), "Teoria e objektit" (teori

dhe kritikë, 2001), "Bibliotekat në Kosovë dhe qasja në informata" (2004), "Modelet e kritikës - Konica, Maloki, Kuteli" (studim, 2005), "Libri i mallit" (studim, 2006), "Etika politike dhe Kosova" (publicistikë, 2006), "Maloki: Fryma nacionale në letërsi, kritikë" (2006), "Rugova: Vizioni nacional" (publicistikë, 2007), "Kritika e tekstit (Arshi Pipa)" (studim, 2007), "Kritika dhe moderniteti" (studim, 2008), "Muret nuk mjaftojnë" (poezi, 2008), "Teknikat themelore të shkrimit" (studim, 2009), "Rrëfime" (poezi, 2012), "Shkrimi akademik, (2013) etj. (Zejnullah Rrahmani)

MIGRIMET E POPULLSISË. Lëvizjet mekanike të popullsisë në hapësirë. Faktorët që kushtëzojnë vëllimin dhe drejtimin e lëvizjeve migruese janë të ndryshëm, si: ekonomikë, socialë, politikë, demografikë, fatkeqësitë natyrore etj. Për shkak të rrethanave historike, gjeopolitike, sociale dhe ekonomike, Kosova paraqet një hapësirë emigruese. Krahas rrethanave të vështira historike, në periudha të caktuara kohore Kosova përballej me migrime të natyrave të ndryshme. Shpërnguljet masive të shqiptarëve, migrimi për punësim dhe kushte më të mira të jetës, migrimi fshat-qytet etj., janë lloje të migrimit që e kanë përcjellë vazhdimisht popullsinë e Kosovës. Sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2011, numri i migrantëve të jashtëm të raportuar nga ekonomitë familjare është 380,826, ose rreth 22% e popullsisë së përgjithshme. Emigrantët kosovarë janë të shpërndarë pothuajse në të gjitha shtetet e Europës, ndërsa një numër i konsiderueshëm i tyre ndodhet edhe në kontinentet e tjera, si në Amerikën Veriore, Azi, Afrikë dhe Australi. (Hazer Dana)

MIHAJLOVIQ Dragolub-Drazha (Dragoljub Draža Mihailović) (1893-1946). Gjeneral serb, udhëheqës i lëvizjes çetnike të Ravna Gorës. Lindi në Ivanjicë të Serbisë. Më 1910 u regjistrua në Akademinë Ushtarake të Serbisë, kurse më vonë iu bashkëngjiti frontit serb gjatë luftërave ballkanike (1912-1913). Gjatë Luftës së Dytë Ballkanike luftoi në kufirin me Shqipërinë (1913). Gjatë Luftës së Parë Botërore luftoi në Shqipëri dhe më vonë ishte i përfshirë në tërheqjen taktike të ushtrisë serbe përmes Shqipërisë në vitin 1915. Pas pushtimit të Jugosllavisë nga forcat e Boshtit, D. Mihajloviq së bashku me një grup mbështetësish organizoi

lëvizjen çetnike të Ravna Gorës në shtator të vitit 1941. Më vonë zgjeroi aktivitetin e tij edhe në Kosovë, duke formuar Korpusin Çetnik të Kosovës më 1942, në radhët e të cilëve kishte kryesisht serbë dhe malazezë nga Kosova. Pas përfundimit të luftës u gjykua për tradhti të lartë dhe krime të luftës. Drazha Mihajloviq njihej mes të tjerave edhe për qëndrimet e theksuara antishqiptare. U ekzekutua në Beograd. (Mrika Limani)

MIHAJLLOVIQ (Mihajlović) Dragan (1921-1993). Mjek, kirurg, ortoped, profesor universiteti. Lindi në Smederevë (Serbi), shkollën fillore e kreu në vendlindje, të mesmen në Beograd. Para Luftës së Dytë Botërore nisi studimet në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare në Beograd, por i përfundoi në Fakultetin e Mjekësisë në Zagreb (1951). Specializohet në kirurgjinë e përgjithshme në Fakultetin e Mjekësisë në Shkup. Specializoi ortopedinë me traumatologji në Beograd në vitin 1966. U emërua shef i ortopedisë në Klinikën e Kirurgjisë në Prishtinë. Mbrojti tezën e disertacionit në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë (1981). Ndërkohë, u emërua ligjërues i lartë i lëndës së kirurgjisë dhe më pas u ngrit në të gjithë titujt universitarë. Ishte autor i shumë punimeve shkencore dhe profesionale në fushën e kirurgjisë, të ortopedisë dhe traumatologjisë. (Cen Bytyçi)

MIHËJESKU Haralambie (Mihăescu) (1907-1985). Gjuhëtar, romanist, akademik rumun. Studioi për filologji klasike në Iashi dhe për gjuhë latine në Romë. Doktoroi më 1936 në



HARALAMBIE
MIHËJESKU

Iashi, ku më pas u emërua profesor i gjuhëve klasike (1936-1950). Ishte pedagog për gjuhën rumune në Universitetin e Frankfurtit (1943-45). Për arsye politike, më 1950 u detyrua të ndërpriste karrierën e tij akademike. Më 1957 u punësua në Institutin e Gjuhësisë në Bukuresht. Më 1965 u zgjodh anëtar i Akademisë Rumune të Shkencave. Publikoi monografi për latinishten në zonat e Danubit në Perandorinë Romake (1960) dhe për ndikimin e greqishtes në rumanishte deri në shek. XV (1966). U mor me studimin e huazimeve latine të shqipes. Ai ka vërejtur mbi 80 fjalë të latinishtes në shqipen


që nuk janë në gjuhët e tjera romane, mbi 150 që nuk janë në rumanishten. Njëherësh ka vërejtur se shumë fjalë të terminologjisë kishtarë të shqipes janë huazime shumë të hershme nga latinishtja. (Pranvera Osmani)

MIJOVIQ (Mijović) Pavle (1914-1996). Studiuës malazias, historian i artit bizantin dhe mesjetar, akademik. Më 1958 mori titullin doktor i shkencave të historisë. Gjatë viteve 1960-1982 punoi në Institutin e Arkeologjisë në Beograd. Ishte profesor i historisë së artit në Fakultetin e Kulturës në Cetinë, Mal të Zi, anëtar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Serbisë dhe anëtar i Akademisë Malazeze të Shkencave dhe të Arteve. Gjatë viteve 1951-1984 realizoi kërkime historike-arkeologjike kryesisht në territore të banuar me ilirë dhe shqiptarë, gjatë antikitetit të vonë dhe gjatë gjithë mesjetës, si në Tivar, Ulqin, Kotorr, Podgoricë, Budvë, Graçanicë, Ulpianë, Pejë etj. Nga këto kërkime shkroi studime nga fusha e historisë, e historisë së artit dhe e arkeologjisë, ndër të cilët do përmendur: “Flori dhe Lauri - mjeshtër dhe gurgdhendës nga Ulpiana” (1963), “Monumentet e krishterimit të hershëm të Prevalit” (1978), “Ulqini dhe Tivari dhe kërkimet arkeologjike e kasteologjike” (1977), “Mbi gjenezën e Graçanicës” (1978) etj. Gjithashtu është autor edhe i disa monografive shkencore dhe katalogëve që ndriçojnë mesjetën e Kosovës dhe të hapësirave të tjera shqiptare: “Patrikana e Pejës” (1960), “Deçani” (1963), “Ulqini” (1981), “Nga trashëgimia kulturore e Tivarit” (1995) etj. (Gjon Berisha)

MIKETIQ (Miketić) Radoslav Musa (1929-1996). Skulptor. Lindi në Pejë. Kreu arsimin fillor dhe të mesëm në vendlindje, ndërsa Shkollën e Lartë Pedagogjike, drejtimi i pikturës, në Beograd, e më pas edhe Akademinë e Arteve Figurative (1955). Punoi në Shkollën e Mesme të Arteve në Pejë (1955-1959), një kohë ishte edhe drejtor i saj. Më pas ishte pedagog i skulpturës në Akademinë e Arteve në Prishtinë. Ishte anëtar i Shoqatës së Artistëve Figurativë të Kosovës që nga themelimi. Në vitet 1975-1976 qëndroi në Akademinë e Arteve Figurative në Romë. Ekspozitat më të njohura personale janë: në Galerinë e Akademisë së Arteve në Beograd (1955), në Foajeun e Teatrit Krahinor në Prishtinë (1970), si dhe në Itali, në Parma (1970), në Romë (1975), në Firence (1976) dhe

më vonë në Piza, Ravena etj. Ishte laureat i disa çmimeve dhe i mirënjohjeve nga fusha e arteve pamore. (Luan Mulliqi)

MIKLOSHIÇ (Miklošič) Franc (1813-1891). Gjuhëtar sloven, sllavist, albanolog, ballkanolog, akademik (Austri). Studioi në Universitetin e Gracit dhe punoi si profesor për një kohë po



FRANC MIKLOSHIÇ


në këtë universitet. Më 1844 u punësua në Bibliotekën Perandorake të Vjenës. Sllavist i shquar, u zgjodh anëtar i Akademisë së Vjenës dhe anëtar korrespondent i Akademisë Franceze. U angazhua politikisht në lëvizjen kombëtare slovene më 1848. Mbahet pionier i ballkanistikës. Për shqipen botoi “Hulumtime shqiptare” (Albanische Forschungen, Vjenë 1870-1871), ku trajtoi elementet sllave e romane në shqipe dhe formën e foljeve të prejardhura në shqipe dhe në disa gjuhë të tjera. Shkroi edhe veprat: “Elementet sllave në rumanishtë”, “Mbi ndikimin e turqishtes në gramatikën e gjuhëve të Europës Juglindore” etj. Përkrahu tezën e prejardhjes ilire të shqipes dhe burimin e ballkanizmave e mendoj prej “elementit të lashtë autokton”, që, sipas tij, është i afërt me shqipen. (Mensur Vokri)

MIKPRITJA. Element sociokulturor që krahas besës, trimërisë, burrërisë dhe nderit zë vend të lartë në sistemin e vlerave të traditës shqiptare përgjithësisht, e në ambientet e Alpeve Shqiptare e rajonin e Kosovës, në veçanti. Përveç kësaj, mikpritja zakonisht përjetohet dhe trajtohet si vlerë që natyrshëm lidhet edhe me vlerat e tjera, siç janë: besa, burrëria, nderi etj. Pritja, strehimi dhe përkujdesja e atyre që trokasin të (pa)ftuar në derë, gjithnjë e më tepër konsiderohet si zakon që i takon së kaluarës, mirëpo politikë migruese që strehojnë individë dhe familje refugjatësh janë përligjur pikërisht në sajë të një tradite të lashtë të mikpritjes në shumicën e vendeve të botës. Nevojtarëve nuk u mbyllet dera. Edhe te shqiptarët, mikpritja lidhet me marrjen e përgjegjësisë për mikun, për strehimin dhe mbrojtjen e tij, për përcjelljen deri jashtë territorit të familjes ose fisit të shtëpiakut. Mirëpo, thënia “bukë, kripë dhe zemër” ka mbijetuar vetëm në traditën shqiptare, më

tepër si imperativ i respektimit të saj, por edhe si përpjekje historike që t'i bashkojë së paku tre komponentë të rëndësishme që lidhen me mikpritjen si vlerë: 1) shtëpia është e "Zotit dhe e mikut", e hapur dhe e gatshme për t'i ofruar strehim dhe mbrojtje atij; 2) në kontekstin e rrethanave të organizimit të jetës pa shtet, familja synon vetëmjaftueshmërinë, pavarësinë ekonomike dhe sigurinë; dhe 3), sofa e shtruar sado e varfër, qoftë edhe me bukë dhe kripë, me metaforën mbi "zemrën", i jep aktit të mikpritjes kuptim që shkon përtej vlerave materiale që mund të ofrohen dhe njëkohësisht e çliron shtëpiakun që varfëria ekonomike të mos bëhet pengesë për të mbajtur "derën e hapur për mikun". "Shtëpiakut shikojta ballin e jo sofrën", është thënia tjetër që aludon në komponentin moral të mikpritjes, në nevojën e krijimit të atmosferës që miku të ndjehet e mirëseardhur, i dëshiruar dhe i mirëpritur.

Mikpritja është ruajtur në kujtesën popullore të shqiptarëve dhe ka mbijetuar më gjatë se në shumë civilizime të tjera edhe në sajë të një ritmi më të ngadalshëm të zhvillimit ekonomik. Ajo shndërrohet në pjesë substanciale të traditës, hyn në kodet zakonore të Kanunit dhe bëhet normë që duhet të respektohet. Mosrespektimi i kësaj norme tërhiqte me vete pasoja që nënkuptonin jo vetëm imazh më të zbehur për individin dhe familjen, por edhe një lloj forme të vetizolimit, që në kontekstin e rrethanave të shkrirjes së individualitetit në grup, gjasat për të mbijetuar jashtë kësaj strukture farefisnore ishin shumë të vogla. (Anton K. Berishaj)

MIKULLOVCI Adem (1937-). Aktor, regjisor, skenarist dhe dramaturg. Lindi në Vushtrri, ku kreu shkollën fillore, ndërsa shkollën e mesme e kreu në Mitrovicë. Shkollën e Lartë



ADEM MIKULLOVCI

Pedagogjike, drejtimin e aktrimit, e përfundoi në Universitetin e Prishtinës. Një kohë studioi edhe në Akademinë e Arteve për Film dhe Teatër në Beograd. Në Teatrin Popullor Krahinor (TPK) interpretoi dhjetëra role, prej të cilave shumica në zhanrin e komedisë, zhanër me të cilin edhe u identifikua pjesa më e madhe e krijimtarisë së tij prej aktori. Disa nga rolet e tij më të suksesshme në skenën e Teatrit Popullor Krahinor janë:

Dëshmitari II tek "Erveheja" (1966), Estragoni te "Duke pritur Godonë" (1970), pastaj Pirrucci te "Hotel Kashta" (1975), Duli te "Dan shejtani" (1979) etj. Me sukses interpretoi role edhe në shfaqjet: "Ushtari i mirë Shvejk", "Të fala sherifit", "Po shkoj në gjah", "Fosilet", "Tri ditët e kiametit", "Halili dhe Hajria", "Miza në vesh", "Njeriu që pa vdekjen me sy", "Makbethi", "Besa e madhe", "Hamleti", "Varri i qyqes", "Konfiteori", "Burri burrë", "Përgjuesi", "Dashnori i nënës sime" etj. Si aktor luajti edhe në filmat artistikë: "Kur isha ushtar", "Sulmi i kuq" (1974), "Era dhe Lisi", "Kur pranvera vonohet" "Proka". Ndërkohë bëri regjinë e shfaqjeve, kryesisht në TPK: "Engjëlli i stacionit", "Dan shejtani", "Pas vdekjes", "Katërbëdhjetë vjeç dhëndër", "Ti mos u përziej", "Shtrati" (2008), "Përgjuesi". Është autor i dramave: "Shtrati", "Përgjuesi", "Dashnori i nënës sime". Luan rregullisht në seriale dhe projekte të tjera televizive. (Arian Krasniqi)

MIKULLOVCI Nazmi (1943-). Ekonomist, inxhinier. Lindi në Vushtrri, arsimimin bazë e mori në Vushtrri dhe Mitrovicë, studimet për elektroteknikë i kreu në Prishtinë, kurse shkencat organizative në Beograd. Pas diplomimit (1965) punoi në flotacion, në metalurgjinë e plumbit dhe pastaj në Fabrikën e Akumulatorëve "Trepça" në Mitrovicë. Në vitin 1976 u zgjodh drejtor i fabrikave të baterive në Mitrovicë,



NAZMI MIKULLOVCI

Pejë, Gjilan dhe Sombor (Serbi). Në vitin 1978 u zgjodh kryetar i këshillit punëdrejtues të kombinatit "Trepça". Në atë kohë "Trepça" ishte në gjendje të rëndë ekonomike dhe organizative. N. Mikullovcu u angazhua që "Trepça" të funksionalizohet si sistem i integruar tekniko-teknologjik dhe ekonomik, kështu që në vitin 1983 "Trepça" bëhet njëra prej pesë kompanive më të suksesshme në Jugosllavi. Në vitin 1984 supozohet se sigurimi shtetëror inskenon vjedhjen e koncentratit të argjendit dhe kjo u mor si pretext për largim të N. Mikullovcit dhe ekspertëve të tjerë nga "Trepça". Gjatë viteve '90 u mor me biznes privat, ndërsa më 2001 u zgjodh menaxher i Trepçës, i administruar nga UNMIK-u. Në këtë detyrë dha një kontribut të çmuar që minierat dhe flotacionet e "Trepçës" të funksionalizohen në tërësi. (Minir Dushi)

MIKULLOVCI-JEMI Jeton (1964-). Karikaturist. Lindi në Mitrovicë. Që në vitin 1996 nis të publikojë karikatura në revistën javore “Koha”, ndërsa nga viti 1997 është karikaturist i rregullt në gazetën e përditshme “Koha ditore”. Kohë pas kohe karikaturat e tij publikohen edhe në gazeta, libra, revista si dhe ueb-faqe jashtë Kosovës. Në vitin 2002 ka botuar përmbledhjen e karikaturave me titull “Jemi ku jemi”. Ka marrë pjesë në disa ekspozita të karikaturës shqiptare brenda dhe jashtë vendit, si në Prishtinë, Pejë, Tiranë, Zagreb, Sarajevë, Rouen (Francë) etj. Gjithashtu ka bërë edhe ilustrime për fëmijë dhe një numër syresh janë botuar në libra të ndryshëm, përfshirë edhe librat shkollorë. (Nehat Islami)

MILANI Mark (Marko Milanov). (1833-1901). Ushtarak dhe shkrimtar malazez. Lindi në fshatin Medun dhe i përkiste fisit malësor të Kuçit. Mbante titullin vojvodë (dukë). Është personazh i njohur edhe në këngët popullore të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. U dallua për trimëri në luftime të ndryshme, por fama e tij u zbeh pas Betejës së Nokshiqit, kur ushtria malazeze u mposht nga shqiptarët që mbronin Plavën e Gucinë. Që atëherë, knjaz Nikolla e largoi nga posti i komandantit. U mor me shkrime letrare, historike dhe etnologjike. Veprat e tij kryesore janë: “Shembuj burrërie e trimërie” (1901), “Fisi i Kuçëve në tregime e në këngë popullore” (1905), “Jeta dhe zakonet e shqiptarëve” (1907) etj. Dy nga këto vepra janë botuar shqip me titullin e përbashkët “Legjenda për shqiptarët” (Prishtinë, 1971). Shkroi sidomos për vëllamërinë, miqësinë, mikpritjen, besën, hakmarrjen, parësinë dhe bajraqet e fiset shqiptare. (Ylberza Halili)

MILENKOVIC (Milenković) Ankica (1943-). Aktore. Lindi në Smederevë (Serbi). Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje. Më 1966 u pranua si aktore në ansamblin e dramës serbe të Teatrit Popullor Krahinor në Prishtinë. Luajti në shfaqje të ndryshme, si: “Ligësitë dubrovnikase”, “Fizikanët”, “E shoqja e Hasan Agës”, “Gjaku i papastër”, “Othello”, “Nita”, “Babai”, “Personi i dyshimtë”, “Mbreti i Batanjohtës”, “Zgjimi i vampirit”, “Karriga që luhet”, “Zona e Zamfirrit”, “Intrigë e dashuri”, “Procesi” etj. Luajti gjithashtu edhe në filma të ndryshëm të “Kosovafilmit”, nga të cilët veçohet roli i saj në filmin “Përroi vërshues” të Besim

Sahatçiu (1983). Më 1985 u nderua me çmimin për rolin më të mirë në takimet “Joakim Vujiq” në Kragujevc (Serbi). Gjithashtu u nderua me “Unazën e artë” të Shoqatës së Krijuesve të Dramës të Serbisë. (Bekim Lumi)

MILOVANOVIQ (Milovanović) Konstantin (Kosta Peqanac) (1879-1944). Udhëheqës i çetnikëve serb para dhe gjatë Luftës së Dytë Botërore, i njohur për qëndrim antishqiptar. Lindi në Deçan, ndërsa fëmijërinë dhe rininë e kaloi në Gurakoc të Istogut. Në vitin 1902 iu bashkua ushtrisë së Serbisë. Më 1904 u largua për në Maqedoni, ku iu bashkua çetnikëve serbë dhe u zgjodh vojvodë i tyre. Si vojvodë çetnik mori pjesë në radhët e ushtrisë serbe dhe luftoi gjatë të dy luftërave ballkanike (1912-1913), si dhe në Luftën e Parë Botërore (1914-1918). Në vitin 1917 me çetnikët e tij organizoi rezistencë kundër forcave të ushtrisë Austro-Hungareze dhe atyre bullgare, të cilën këta të fundit e shtypën. Ndërmjet dy luftërave botërore me çetën e tij kreu shumë krime ndaj popullsisë shqiptare. Mori pjesë në Luftën e Dytë Botërore me grupin e çetnikëve të tij dhe bashkëpunoi me qeverinë kuislinge të Milan Nediqit dhe ushtrinë gjermane, deri më 1942. Bashkëpunimi me gjermanët u ndërpre nga vetë gjermanët, si pasojë e mungesës së efikasitetit dhe besueshmërisë të trupat e tij çetnike. U vra nga çetnikët e Drazha Mihajloviqit më 1944. (Mrika Limani)

MINI Imzot Nikollë (1924-1992). Titullar i Kishës Katolike. Lindi në Ferizaj, mësimet e para i kreu në vendlindje dhe më pas i vazhdoi në Shkup. Shkollimin fetar e vazhdoi në Seminarin Dioqezian në Prizren, ndërsa studimet teologjike në Institutin Papnor në Shkodër dhe i përfundoi në Fakultetin Teologjik në Zagreb. U shugurua prift në vitin 1950 në Zagreb, ndërsa meshën e parë e mbajti në Katedralen e Krishtit në Shkup. Shërbeu si kapelan e pastaj u emërua famullitar në Guci, pastaj në Novosellë, më pas vazhdoi në Velezhë dhe në Prizren. Për nevojat e klerit katolik në famullitë shqiptare ka përgatitur tekste të ndryshme dhe libra të lutjeve, si: “Bekimi me Sakramend” (1964), “Ungjilli i së dielës” (1975), lutjet për festat e Pashkëve “Java e Madhe” (1976) etj. Në vitin 1962 nisi botimin e revistës fetare e kulturore “Zani i Zojës Cernagore”, ndërsa në vitin 1970 nxori numrin

e parë të revistës mujore “Drita”. Botoi edhe përmbledhjen me këngë kishtarë “Kantalin kishtar shqiptar” (1974). (Pjetër Përgjoka)

MINIERA “TREPÇA” NË STANTËRG, MITROVICË. Ndodhet në verilindje të Kosovës, afër Mitrovicës. U themelua nga kompania angleze LMTD në vitin 1930. Ishte



MINIERA “TREPÇA” NË STANTËRG

miniera më e madhe në Europë, nga e cila janë nxjerrë mbi 33 milionë tonë xeherorë të plumbit dhe zinkut (Pb-Zn) me përmbajtje 6.75% Pb dhe 4.3% Zn, ndërsa në vitet e para kjo përmbajtje arrinte mbi 16% metal. Në kohë të ndryshme Stantërgu ka pasur rezerva të ndryshme. Në vitin 1978 rezervat e përgjithshme të xehe ishin rreth 18 milionë tonë. Nga pikëpamja gjeologjike, themelin e vendburimit e përbëjnë rreshtet e kristalizuara të paleozoikut, që janë mbuluar nga krijimet e vullkanizmit terciar. Trupat xeherorë kanë seksione me përmasa të ndryshme (100-5,000-7,000 m²). Gjatë Luftës së Dytë Botërore gjermanët e mbajtën minierën në gjendje pune, por me prodhim të zvogëluar, ndërkaq në periudhën 1945-1990 miniera punoi pandërprerë, me prodhim vjetor 600,000 tonë xeherorë të Pb-Zn në vit. Në fillim, prodhimi në Stantërg bëhej me pajisje primitive, ndërsa më vonë u pajis me mjete bashkëkohore, me produktivitet të lartë. Nxjerrja e xeherorit në Stantërg arrihet me zbatimin e sistemit të shfrytëzimit me rrëzimin e nënkateve të tavanit dhe mbushje të hapësirave. Mbushja e hapësirave kryhet me material shterp (shiste), i cili nxirret nga miniera sipërfaqësore e ashtuquajtur “Majdan”. Në vitet 1990-1999 serbët e shkatërruan këtë sistem të mbushjes, duke lënë të gjitha punishtet të pambushura,

ndërsa tani mbushja e hapësirave të shfrytëzuara kryhet me hidrombushje. Fuqia punëtore në minierë ishte kryesisht shqiptare, kurse personeli teknik-inxhinierik ishte i huaj. Inxhinierët e parë shqiptarë filluan punën nga fundi i viteve ‘50. Pas hapjes së Fakultetit të Xehetarisë dhe të Metalurgjisë në Mitrovicë (1970), numri i ekspertëve shqiptarë rritet ndjeshëm. Në vitin 1990, me ndërhyrje të policisë, u nxorën nga puna 2,700 punëtorë shqiptarë. Motivet për largim nga puna ishin politike, në shenjë hakmarrje për grevën e 1,300 minatorëve, që kundërshtuan ndryshimet e kushtetutës për supremimin e autonomisë së Kosovës. (Islam Fejza)

MINIERA E BOKSITIT, KLINË. Ndodhet në jugperëndim të Klinës, në serinë e sedimenteve të kretakut të sipërm të Malit të Gremnikut dhe të rrethinës së tij. Boksiti shfaqet këtu me një strukturë faciale të gjatë rreth 15 km dhe e gjerë 0.5-3.5 km, e cila fillon nga fshati Lug (Dollc) në veri dhe përfundon në Kështjellë (Zatriq), që përfshin një sipërfaqe rreth 15 km². Në këtë strukturë faciale në boshllëqet stratigrafike ndërmjet gëlqerorëve të turanionit dhe atyre mastrite të kretakut ndodhen grumbullime të trupave minerale të boksiteteve. Këto boksitete eolitike, me ngjyrë të kuqe, janë të llojit të diasporës dhe më së shpeshti kanë këtë përbërje: Al₂O₃=46.52 %, SiO₂=1.5-4.0 dhe Fe₂O₃=30-40 %. Për shkak të përmbajtjes së lartë të përbërësit, Fe₂O₃ janë quajtur edhe boksitete feroze. Boksitet e Gremnikut u zbuluan dhe u hulumtuan në vitin 1954/55. Në vitin 1966 u themelua Miniera e boksitit “Kosova” në Klinë, me prodhim vjetor 100,000 tonë. Krahas nxjerrjes së boksitit u kryen edhe hulumtimet gjeologjike rajonale (1966-1989), me çrast u arrit të zbulohen rreth 60 trupa minerale, nga të cilët 33 janë hulumtuar hollësisht, 20 janë pjesërisht ose tërësisht me dalje në sipërfaqe, kurse 13 janë të mbuluara. Rezervat e boksitit janë 7 milionë tonë të kategorive A, B dhe C₁. Në periudhën 1966-1981 janë nxjerrë 2,25 milionë tonë dhe janë shitur në Rumani. Nga viti 1981 në Gremnik nxirren edhe gurët gëlqerorë, rudiste gastrite, të përshtatshëm për ndërtimtari, industrinë kimike dhe metalurgji. (Minir Dushi)

MINIERA E GOLESHIT. Minierë e magnezitit, e hapur në vitin 1928, që ndodhet

12 km në perëndim të qytezës së Lipjanit. Miniera vlerësohet si njëri ndër vendburimet më cilësore të magnezitit në Ballkan dhe më gjerë. Në vitet 1946-1947 u ndërtua furra e parë rrotulluese bashkëkohore për prodhimin e magnezitit të pjekur kaustik. Në vitet 1965-1973 fillon fazë e re e zhvillimit të minierës së Goleshit, kur u lëshua në punë pusi kryesor dhe u krye rikonstruktimi i brendshëm i minierës, i seperacioni optik dhe me lëngje për veçimin e mineralit nga materiali shterp. Vendburimi i magnezitit në Golesh shtrihet në pjesën jugore të masivit peridotit Golesh-Dobroshec. Magneziti lidhet me shkëmbinj të ultrabazikë (dunite, peridotite, serpentinite). Vendburimi është i tipit hidrotermal. Trupat minerale shfaqen në formë damarësh me rënie 50-60° nga lindja. Përqendrimi më i madh i magnezitit me leverdi të madhe ekonomike gjendet në zonën e fshatit Magurë. Shumica e damarëve xeherorë kanë trashësi prej 0.5-3.0 m, me trashësi mesatare 2.0 m. Trashësia më e madhe që është konstatuar, arrin deri në 18 m. Gjatësia e damarëve ndryshon prej 100-500 m. Shtrirja e damarëve në thellësi është hulumtuar deri në mbi 300 m. Rezervat e vlerësuara të magnezitit janë rreth 2,4 milionë tonë me përmbajtje MgO-46.22%, SiO₂-2.76%, CaO-0.89% dhe okside (Fe, Al, Mn, R₂O₃)-0.57%. Ekzistojnë edhe resurse të tjera të magnezitit që vlerësohen në 2,5 milionë tonë. Miniera vazhdon të administrohet nga Agjencia Kosovare e Privatizimit dhe nuk funksionon më, (Naser Peci)

MINIERA E KAOLINIT, KARAÇEVË. Ndo dhet në Karaçevë afër Kamenicës, 12 km nga rruga Dardanë-Bujanoc. Kaolini shfaqet në pamje të thjerrëzave, që kanë përmasa të ndryshme (8-28x4-7 m). Vendburimi i kaolinës në Karaçevë shtrihet në sipërfaqe 1km², por sipërfaqja shfrytëzuese është rreth 0.5 km². Nxjerrja e kaolinit kryhet me mihje nga sipërfaqja. Raporti i trashësisë së mbulesës shterpë ndaj trashësisë së kaolinit është shumë i përshtatshëm (0.5m³:1.0 m³). Rezervat e përgjithshme (A+B+C₁) të verifikuara të kaolinit janë 5,6 milionë tonë (1983). Përveç këtyre janë vlerësuar edhe 5, 2 milionë tonë rezerva C₁ dhe C₁, që janë perspektive. Prodhimi vjetor i kaolinit ishte rritur nga viti në vit, në fillim 7,300 t/v më 1961 për të arritur 37,500 tonë në vitin 1975. Problem paraqitet përmbajtja e alkalineve

(Na₂O dhe K₂O) dhe e hekurit. Në disa pjesë të vendburimit kjo përmbajtje është 5%, madje në disa vendburime edhe në rreth 6% të alkalineve, në një kosh që kjo përmbajtje nuk duhet të jetë mbi 4%, pasi ato shkaktojnë shformimin e prodhimeve. Analizat kimike të mostrave të kaolinit kanë treguar këtë përmbajtje: SiO₂=71.58%, Al₂O₃=18.20%, Fe₂O₃=0.94%, Fe₂O₃ i tretur=0.86%, TiO₂=0.18% dhe humbja nga pjekja 2.76%. Kaolini i Karaçevës si lëndë e parë është shumë i përshtatshëm për industrinë e qeramikës, në industrinë e prodhimit të izolatorëve elektrikë për prodhimin e pllakave për mure, dysheme dhe mozaikë, në industrinë e letrës, për shpime në pusët e naftës etj. Për këtë qëllim në Kamenicë ishte ndërtuar fabrika për prodhimin e pllakave të qeramikës (1971) më aftësi prodhuese prej 750,000 m² në vit. (Minir Dushi)

MINIERA E KISHNICËS. Minierë e xeherorit të plumb-zinkut (Pb-Zn), e hapur në vitin 1952 në një zonë gjeologjike të ndërlikuar, ku mineralizimet e xeherorit Pb-Zn janë të rrethuar



MINIERA E KISHNICËS

me struktura shkëmbore andezite në dysheme dhe me struktura serpentinite apo intruzione shkëmbore në pjesën e tavanit. Sipas mënyrës së formimit, dallohen trupat xeherorë të pasur në serpentinite dhe trupat xeherorë të varfër në filite. Nga sasia e rezervave të zbuluara, miniera e Kishnicës ka qenë më e rëndësishme në rajon, por nga përmbajtja e metalit ishte prapa Hajvalisë dhe Novobërdës. Hapja e minierës është bërë me galeri horizontale, me gjatësi prej 664 m, që sot paraqet horizontin II (kuota 660 m). Më vonë është hapur dhe thelluar pusi nga sipërfaqja (kuota 720 m), që i ka lidhur me radhë horizontin I (kuota 710 m), II (kuota

660 m), III (kuota 610 m), IV (kuota 560 m) dhe V (kuota 510 m). Në vitin 1965 filloi hapja dhe shfrytëzimi i mihjes sipërfaqësore, në të cilën është shfrytëzuar xeherori me cilësi të dobët. Mihja ka filluar në kuotën 870 m dhe ka përfunduar me të pestin në kuotën 680 m. Nga ky nivel është hapur oxhaku qendror, nëpër të cilën tërë xeherori i prodhuar nga mihja rrëshqet me gravitet deri në horizontin II, ku bëhet ngarkimi në kompozicionin e trenit të galerisë së hapjes, duke e bartur deri në flotacionin e Kishnicës. Xeherori më i pasur ndodhet në trupat xeherorë I, II dhe V, të cilët u shfrytëzuan nga horizontet e poshtme të minierës. Nga këtu xeherori është bartur me trenin elektrik deri në bunkerin pranues të flotacionit. Miniera nga viti 2000 ndodhet e vërshuar dhe konsiderohet që rezervat e mbetura nuk e arsyetojnë rihapjen e saj. (Shyqeri Kelmendi)

MINIERA E KROMIT “DEVA”, GJAKOVË. Ndodhet në masivin peridotiko-serpentinit në Devë afër Gjakovës. Është vendburimi më i madh i kromit në Kosovë. Nga ky vendburim janë nxjerrë rreth 300,000 tonë xeherorë kromi. Hulumtimet e para gjeologjike janë kryer qysh në vitin 1925. Të rëndësishme ishin edhe vendburimet: Qafa e Prushit, Bobaj, Bokë, Qereti, Maja 1 dhe Maja 2. Nën emërtimin e kësaj miniere ishin përfshirë mbi 80 dalje të vogla dhe të parregullta të kromit në sipërfaqe. Në përgjithësi, cilësia e kromit nuk ishte aq e mirë. Gjatë Luftës së Dytë Botërore xeherorët e kromit u shfrytëzuan nga italianët dhe gjermanët, së bashku me vendburimet e kromit në Shqipëri. Pas luftës miniera e Devës sërish filloi prodhimin (1949), por në sasi të kufizuar, të cilat vinin gjithnjë duke u pakësuar, ndërsa importi i kromit nga Shqipëria rritej nga viti në vit. Kështu, në vitin 1973 u prodhuan gjithsej 1,000 tonë krom, kurse importi në atë vit arriti në 77,800 tonë. Xeherorët e kromit të vendburimeve të Kosovës ishin të cilësive së dobët (klasa III), prandaj ishte i nevojshëm pasurimi i tyre. Rezervat e kromit të rajonit të Gjakovës dhe të Rahovecit janë shterur pothuajse krejtësisht dhe prodhimi i kromit është simbolik. (Minir Dushi)

MINIERA E NOVOBËRDËS (1952-). Minierë e xeherorit të plumb-zinkut, e njohur që nga periudha iliro-romake, afër kështjellës

mesjetare të Novobërdës. Në periudhën 1952-1960 ka punuar miniera “Novobërda e Vjetër”, e cila veçohej me përbërje të lartë të mineralit. Në afërsi të saj, në vitet 1955-1963 zbulohet vendburimi Farbana, me rezerva mbi 15 milionë tonë të xeherorit të pasur me plumb, zink dhe argjend. Miniera është hapur me galeri-horizonte në nivelet: II (900 m), III (846 m), IV (800) V (760 m) dhe VI (680 m). Përmes pusit të brendshëm janë hapur horizontet VII (620 m) dhe VIII (560 m) dhe ndërhorizonti 650 m. Më vonë horizontet janë lidhur me pusin kryesor të thelluar nga sipërfaqja (+1048 m) deri në kuotën +455 m. Pusi është siguruar me beton (40 cm), i pajisur me skip-kafaz (me kundërpeshë) dhe me makinë ngritëse të tipit “Köepe”, me 4 litarë secili $d=32$ mm. Në vendburim shfrytëzohen 8 trupa xeherorë. Trupat xeherorë kanë formën e zgjatur, me trashësi nga 2-60 m. Kontakti ndërmjet xeherorit dhe shkëmbinjve rrethues është i dukshëm dhe i qartë. Përdoren disa sisteme shfrytëzimi, por dominon sistemi me shembje të nënkateve nga lart-poshtë dhe metoda magazinore. Pusi është jashtë funksionit, kështu që xeherori grumbullohet në nivelin e horizontit VI dhe me kamionë bartet në flotacionin e Kishnicës. Kjo minierë është në qendër të mineralizimeve periferike: Milak, Lugu i Derrave, Lugthati, Pllavica etj., që paraqesin një perspektivë të mirë për shfrytëzim. (Shyqeri Kelmendi)

MINIERA E STREZOCIT. Vendburimi Guri i Bardhë-Strezoc, i hapur në vitin 1962, është i llojit hidrotermal-sedimentar dhe ndodhet në pjesën veriore të pellgut të Kamenicës. Përbëhet nga tetë trupa të ndryshëm të magnezitit, me rezerva të përgjithshme 5,6 milionë tonë me këtë përmbajtje: MgO-39.46%, SiO₂-5.62% dhe CaO-7.87%. Perspektiva e minierës “Guri i Bardhë” varet nga zgjidhja e problemit të teknologjisë së përpunimit të xeherorit (pasurimit), e cila ka përbërës të dëmshëm, si dhe të nxjerrjes së magnezitit nga vendburimi në thellësi të trupave minerale. Punimet kërkimore-zbuluese me veprime të ndryshme u kryen në vitet 1956-1974, kurse nxjerrja e magnezitit me mihje nga sipërfaqja filloi në vitin 1962 dhe vazhdoi me nxjerrjen nëntokësore në vitin 1986. Në Kamenicë stabilimenti për sinterizim filloi punën më 1974. Kapaciteti vjetor nominal

i këtij stabilimenti ishte rreth 20,000 tonë sinter magnezit në vit. Trupat xeherorë kanë gjatësi deri në 450 m dhe gjerësi deri 190 m. Thjerrëzat xeherore përmbajnë 30,000 deri 1,000,000 tonë magnezit. Bazamenti është i ndërtuar nga shkëmbinj të kristalinë të masivit dardan. Trupat e magnezitit janë të vendosur në shkëmbinj të ujërave të ëmbla, siç janë: mermerët, gëlqerorët dolomitikë, alevrolitet, ranorët dhe tufet të moshës oligocen i sipërm deri miocen i poshtëm. Në pikëpamje mineralogjike shfaqen magneziti, kalcedoni, opali, kalciti dhe dolomiti. Trupi i magnezitit zakonisht është masiv, me kokrriza shumë të imëta deri kriptokristalin, me ngjyrë të bardhë, gri ose të verdhë, nganjëherë të shtresëzuara kryesisht brekçioze dhe të cementuar nga dolomite apo matriksi nga opali. Ekzistojnë edhe damarë të vegjël, që përbëhen nga dolomiti, kalciti dhe kalcedoni. (Naser Peci)

MINIERAT E HEKUR-NIKELIT. Përbëhen nga dy vendburime: Kodra e Goleshit dhe Çikatova, të hapura në vitin 1984. Vendburimi Kodra e Goleshit ndodhet rrëzë malit të Goleshit, kurse Çikatova në masivin e Dobroshecit, rreth 20 km në perëndim të Prishtinës. Shtrirja e xeherorit në vendburim është e përshtatshme për eksploitim: trashësia e xeherorit është 10 m dhe e mbulesës së dheut sipër xeherorit po ashtu është 10 m. Pra, koeficienti i zbulimit është shumë i përshtatshëm 1:1 (t/m³). Krijimet gjeologjike janë shumë të buta, që bëjnë të mundur nxjerrjen e xeherorit pa lëndë eksplozive, duke përdorur eskavatorë. Përmbajtja e metalit, që sillet 1.33% nikel dhe 0.06% kobalt nuk është e njëtrajtshme. Prodhimi i programuar i xeherorit të Ni-Co ishte 983,000 tonë në vit (në raport 40% nga Kodra e Goleshit dhe 60% nga Çikatova), që në praktikë nuk është arritur. (Islam Fejza)

MINISTRIA E ARSIMIT, E SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË (MASHT) (Arkitektura). Ndërtesë administrative e MASHT-it, e ndërtuar për nevojat e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Me projekt është paraparë që MASHT-i dhe Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës (ASHAK) të kenë ndërtesa të veçanta, por njëkohësisht të jenë të lidhura përmes urave lidhëse. Zgjidhja funksionale e këtij projekti sugjeron funksione të ndara



MINISTRIA E ARSIMIT, E SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË

për të dy institucionet. Objekt i veçantë dhe i shfrytëzuar nga të dy institucionet është paraparë auditoriumi, i cili me projekt paraqet ndërtesë më vete. Struktura fizike e objektit të MASHT-it dhe ASHAK-ut zhvillohet si tërësi e përbashkët në nivele të themeleve dhe të bodrumeve për të vazhduar më tej në lartësi P+3+NK, si objekte të veçanta, me arkitekturë më vete, por në harmoni me njëra-tjetrën. Projekti arkitektonik është punuar në vitin 2005 nga arkitektët kosovarë M. Haziri dhe A. Loxha, ndërsa punët ndërtimore i realizoi dhe i përfundoi në vitin 2009 ndërmarrja ndërtimore "Altrade" nga Prishtina. Objekti ka sipërfaqe rreth 8,600 m², për akomodimin e rreth 300 punëtorëve dhe me hapësirat për kabinetin e ministrit, kabinetin e sekretarit permanent (me zyrën ligjore, zyrën për bashkëpunim ndërkombëtar, zyrën për planifikim dhe analiza dhe zyrën për inspektim), të departamentit të arsimit, të departamentit të administratës dhe të financave, të sallës për mbledhje me 150 vende si dhe hapësirat për shërbime përcjellëse në bodrum. Stili bashkëkohor i arkitekturës, i shprehur në strukturën, vëllimin dhe prezentimin vizual të objektit, përmes aplikimit të teknologjisë së ndërtimit dhe përdorimit të materialeve të kohës, ka krijuar një imazh të ndryshëm në këtë pjesë të qytetit. (Vlora Navakazi)

MIRATOÇI. Fshat në kufi me Maqedoninë, 6 kilometra në jug të Preshevës, shtrihet ndërmjet 460 dhe 510 m të lartësisë mbidetare, në shpatet lindore të Karadakut. Ngastra e fshatit kap edhe pjesën burimore të lumit Banjka, së bashku me vetë burimin. Në vitin 2002 fshati kishte 2,986 banorë, prej të cilëve rreth 30% ndodhen me punë të përkohshme në botën e jashtme. Rreth 700 ekonomi familjare të fshatit Miratoc merren me bujqësi, ndërsa remitancat janë një burim i rëndësishëm i të ardhurave për popullsinë. Fshati shtrihet në një sipërfaqe prej 2,505 ha, prej të cilave një pjesë e konsiderueshme është tokë bujqësore. Fragmentimi i pronave dhe dendësia e madhe agrare pengojnë zhvillimin e bujqësisë intensive. Popullsia e fshatit merret me kultivimin e perimeve, drithërave, e më pak të duhanit dhe pemëve, apo me blegtori. Nga objektet e standardit shoqëror ka shkollën fillore, dy paralele të mësimi parashkollor, disa njësi tregtare dhe shërbyese etj. (Arsim Ejupi)

MIRDITA Dedë (1937-). Gazetar. Lindi në Dobërdol të komunës së Klinës. Filloren e mbaroi në vendlindje, të mesmen në Prishtinë, ndërsa studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe i kreu në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Nga viti 1960 deri më 1967 punoi në arsim, pastaj nisi punën në “Rilindje”. Si gazetar shkroi kryesisht për çështjet e arsimit. Gjatë viteve 1979/80 ishte kryeredaktor i gazetës arsimore “Shkëndija”. Detyrën e ndihmëssekretarit për Informim të Kosovës e ushtroi gjatë viteve 1981/1982, për t’u rikthyer më pas në “Rilindje”. Gjatë viteve 1984-1988 ishte korrespondent i “Rilindjes” nga Beogradi. Pas vitit 1988 një kohë punoi mësues i fëmijëve shqiptarë në diasporë. Që atëherë jeton në Gjermani. (Zenun Çelaj)

MIRDITA Kolë (1976-1998). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), dëshmor. Lindi në fshatin Ranoc të komunës së Klinës. Radhëve të UÇK-së iu bashkua në fillim të vitit 1998. Mori pjesë në betejat në Drenicë e Dukagjin dhe në Lugun e Drinit. Më 9 korrik 1998 ra i goditur nga një granatë në kufirin Kosovë-Shqipëri, te vendi i quajtur Rrasa e Zogut, derisa po kthehej me një grup prej më se 400 luftëtarësh të UÇK-së nga Shqipëria, ku ishin pajisur me armatim. Tri vjet më vonë, në qendër të Zllakuqanit u ngrit lapidari në nderim të veprës së dëshmorit K. Mirdita. (Fetnete Ramosaj)

MIRDITA Zef (1936-2016). Historian, profesor universitar. Lindi në Prizren, ku kreu arsimin fillor, gjimnazin klasik e kreu në Pazin dhe Zagreb, ndërsa studimet në Fakultetin



ZEF MIRDITA

e Teologjisë në Zagreb (1965). Më 1966 u kthye në vendlindje si profesor në gjimnazin e Prizrenit, ku ligjëroi lëndët histori, sociologji dhe gjuhë frënge. U angazhua në Universitetin e Prishtinës (UP) për gjuhën latine për studentë të historisë dhe të albanologjisë, ndërsa më 1967 u emërua asistent në degën e historisë të Fakultetit Filozofik të UP-së. Më 1972 në Universitetin e Zagrebit mbrojti temën e doktoraturës dhe specializoi në Universitetin “La Sapienza” të Romës dhe më pas në Haidelberg (1976-1977) dhe Munih (1991-1992), Gjermani. Në vitin 1983 u zgjodh profesor ordinar në UP. Ishte anëtar i Komitetit Nacional të Jugosllavisë (1980-1990) për ballkanologji dhe anëtar i redaksisë kosovare për “Enciklopedinë e Jugosllavisë”. Në vitin 1991 u zgjodh anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Në vitin 1993 u largua nga Kosova dhe veprimtarinë shkencore e vazhdoi në Kroaci, si këshilltar shkencor në Institutin e Historisë (1993-1997) e më pas si ligjërues i historisë së kohës së vjetër në Universitetin “J.J. Strossmayer” të Osjekut, Kroaci (1997-2007). Mori pjesë në shumë kongrese shkencore dhe ligjëroi në disa qendra universitare si profesor mysafir. Është autor i një sërë botimesh dhe i një numri të madh studimesh shkencore. Është autor i librave shkencorë “Studime dardane” (1979), “Antroponimia e Dardanisë në kohën romake” (1981), “Mitet dhe mitologjia në antikë, funksioni dhe trajtimi i tyre” (1988), “Krishterimi ndër shqiptarë” (1998), “Religjioni dhe kultet e dardanëve dhe Dardanisë në antikë” (2001), “Vllahët në historiografi” (2004) etj. Është bartës i një sërë mirënjohjesh dhe dekoratash për kontributin e dhënë në fushën e shkencës. Vdiq në Zagreb. (Arben Hajdari).

MIRIQ (Mirić) Momir (1927-). Agronom, profesor universiteti. Lindi në Gushtericë të Poshtme të Lipjanit, gjimnazin e kreu në Prishtinë, Fakultetin e Bujqësisë në Universitetin e Beogradit (1953). Po në këtë universitet

mbrojti edhe tezën e disertacionit (1974). Punoi në Lidhjen e Kooperativave dhe në Stacionin e Bujqësisë në Prishtinë. Më vonë punësohet në Institutin e Blegtorisë dhe të Veterinarisë, si udhëheqës i seksionit për ushqimin e kafshëve shtëpiake (1962). Zgjidhet bashkëpunëtor i lartë shkencor (1980) dhe më pastaj mësimdhënës në Fakultetin e Bujqësisë në Prishtinë për lëndën e të ushqyerit të kafshëve shtëpiake (1983). Është themelues i laboratorit për përcaktimin e vlerës ushqyese të ushqimeve. Ka qenë për shumë vjet drejtor i Institutit të Blegtorisë dhe të Veterinarisë dhe ka dhënë kontribut në zhvillimin e blegtorisë dhe avancimin e punës kërkimore-shkencore. (Ragip Kastrati)

MISINI Hajrulla (1966-). Veprimtar, luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare (UÇK). Lindi në Kumanovë. Mbaroi Shkollën e Lartë Pedagogjike në Gjakovë. Më vonë kreu studimet për histori në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Tetovës. Që në moshë të re ishte i përfshirë në veprimtari ilegale. Me fillimin e luftës në Maqedoni, në vitin 2001 ishte njëri ndër themeluesit e Brigadës 113 "Ismet Jashari-Kumanova" dhe pjesëtar i komandës së shtabit të kësaj brigade. Gjatë periudhës së luftës, ishte i njohur me nofkën "Komandant Shpati". Pas luftës ishte i dyshuari i vetëm për njërin nga katër "Rastet e Hagës" (Penda e Likovës), por u amnistua bashkë me të akuzuarit e tjerë në vitin 2011 nga Parlamenti i Maqedonisë. Pas formimit të Partisë Bashkimi Demokratik për Integritim, u bë pjesë e saj. Ushtrroi disa funksione në institucionet shtetërore të Maqedonisë. Dy mandate ishte deputet i BDI-së në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë. Ka të botuara disa vepra letrare. (Fehari Ramadani)

MISINI Misin (1957-). Inxhinier i ndërtimtarisë, profesor universiteti. Lindi në Brrut të Dragashit, shkollimin fillor dhe të mesëm i kreu në Dragash, ndërsa studimet në Fakultetin Teknik të Universitetit të Prishtinës (UP). Studimet pasuniversitare i përfundoi në Universitetin e Zagrebit, ndërsa tezën e disertacionit të doktoratës e mbrojti në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe të Arkitekturës të UP-së. Në vitin 1983 u zgjodh asistent dhe më pas merr titujt përkatës universitarë në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe të Arkitekturës. Mori pjesë në kongrese

shkencore, simpoziume dhe konferenca të fushës së inxhinierisë së ndërtimit, brenda dhe jashtë vendit. Është autor i një sërë punimesh shkencore dhe profesionale. Ishte i angazhuar edhe në shumë projekte nga fusha e ndërtimeve. Është autor i disa dispensave për studentë për lëndët e inxhinierisë së tërmeteve dhe teorisë së plasticitetit. Fusha kryesore e studimeve të tij është inxhinieria sizmike e lëkundjeve të strukturave. Ka ushtruar edhe funksione drejtuese si prodekan në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe të Arkitekturës. (Naser Kabashi)

MISINI Nazmi (1954-). Gazetar. Lindi në Shtime. Shkollimin fillor e kreu në vendlindje, gjimnazin në Ferizaj, ndërkaq në Prishtinë kreu Fakultetin Juridik, drejtimin gazetari-diplomaci (1978). Si nxënës i gjimnazit shkroi dhe botoi poezi, tregime dhe artikuj publicistikë në revista dhe gazeta në Prishtinë dhe Shkup. Gjatë studimeve punoi në gazetën e studentëve "Bota e re", pastaj në Radiotelevizionin e Prishtinës, në gazetën "Komunisti" dhe "Rilindja", ku kryesisht shkroi analiza dhe komente politike. Në janar të vitit 1990 u zgjodh kryeredaktor i gazetës "Rilindja". Pas luftës punoi redaktor në gazetën: "Kosova sot", "Gazeta e re", "Pavarësia news", "Lajm" etj. Është gazetar-redaktor në Radio Kosova, ku udhëheq një emision të debateve. Është autor i librit "Pavarësia e Kosovës në mediet e shkruara". (Shefqet Rexhepi)

MISIONET KATOLIKE SHQIPTARE. Misionet e Kishës Katolike, të themeluara nga Ipeshkvia e Kosovës, ku jetojnë besimtarë katolikë shqiptarë në SHBA, Zvicër, Austri, Gjermani dhe Kroaci. Misionet janë qendra të organizimit fetar dhe liturgjik, mirëpo roli i tyre është i rëndësishëm edhe në planin kulturor, në ruajtjen e gjuhës, traditës dhe identitetit kombëtar. Në Amerikë veprojnë tri misione të këtylla: Kisha Shqiptare "Zoja e Shkodrës" në Nju-Jork (e themeluar në vitin 1969), Kisha Shqiptare "Zoja e Shqiptarëve" në Detroit (e themeluar më 1977), Kisha Shqiptare e Shën Palit në Detroit (e themeluar në vitin 1981). Nga misionet e hershme është edhe ai i Zvicrës, i cili e filloi veprimtarinë në vitin 1991 në Kishën e Madhe të "Shën Gjergjit" në Sursee të Lucernit. Në fillim Misioni Katolik Shqiptar u vendos në Kriens dhe pas tre vjetësh u bart në Littau, në

kushte më të mira për punë. Në vitin 2003 u hap qendra e dytë me seli në Sironach dhe më 2005 u hap edhe qendra e tretë, me seli në Aarau. Nga fillimi i vitit 2010 misioni u vendos në Lucern, ku ka në përdorim kishën, sallat, zyrat, kapelën, pra të gjitha kushtet për punën të rregullt. Kisha Katolike e Kosovës që nga vitet '60 u kujdes për shqiptarët që jetonin në Kroaci, por misioni u zyrtarizua vetëm në vitin 1991. Misionar i parë ishte dom Dodë Gjergji, tani ipeshkëv i Kosovës. Aktualisht misioni vepron në tërë Kroacinë, ndërsa qendrën e ka në Zagreb. Misioni ekziston edhe në Gjermani, i cili është themeluar më 1982 me seli në Shtutgart. Misioni Katolik Shqiptar vepron edhe në Austri, i cili u themelua më 1993 në Vjenë dhe ka nën përkujdesje edhe besimtarët shqiptarë në Çeki. Pranë këtyre misionëve zhvillohen edhe aktivitete të ndryshme kulturore, edukative dhe humanitare. (Ndue Ukaj)

MISIONI EUROPIAN PËR SUNDIMIN E LIGJIT NË KOSOVË (EULEX). Misioni më i madh civil i Bashkimit Europian (BE) në kuadër të politikës së përbashkët të sigurisë dhe të mbrojtjes. U themelua me vendim të BE-së në shkurt të vitit 2008, por kapacitetet e plota operacionale i arriti në prill të vitit 2009. Mandat kryesor ka përkrahjen e autoriteteve kosovare në forcimin e sundimit të ligjit, veçanërisht të sektorit të drejtësisë, të doganave dhe të policisë. Në zhargonin e institucioneve europiane roli i EULEX-it është përshkruar si mision i “monitorimit, mentorimit dhe këshillimit” i autoriteteve kosovare. Gëzon përgjegjësi ekzekutive në disa lëmi të ndryshme, si krimet e luftës, krimi i organizuar dhe korrupsioni. Ndonëse i shoqëruar me pritje të mëdha, një varg kritikash dhe skandalesh e kanë zbehur dukshëm besimin e opinionit të gjerë kosovar ndaj këtij misioni. Mandati i misionit përfundon në qershor të vitit 2016. (Ilir Dugolli)

MISIONI I PËRKOHSHËM I KOMBEVE TË BASHKUARA NË KOSOVË (UNMIK). Misioni i vendosur me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1244/99, pas tërheqjes së ushtrisë serbe. Kymision përbënte administratën e përkohshme civile ndërkombëtare, e cila gjatë periudhës 1999-2008 qeverisi me Kosovën. Ndërkaq, pas shpalljes së pavarësisë, nga viti 2008, UNMIK-u mbeti mision kryesisht



SELIA E UNMIK-UT NË PRISHTINË

këshillëdhënës. Në krye të UNMIK-ut ishte Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së (PSSP), i cili ishte autoriteti më i lartë vendimmarrës në Kosovë. Në pikëpamje organizative, UNMIK-u përbëhej nga 4 “shtylla”, 4 fusha të caktuara, që funksiononin nën përkujdesjen e katër organizatave ndërkombëtare: OKB-së, UNHCR-së, OSBE-së dhe BE-së. Shtylla e parë ishte përgjegjëse për administrimin civil ndërkombëtar, e dyta për çështje humanitare, e treta për ndërtimin e institucioneve dhe e katërta për rindërtimin e Kosovës. Ndërkaq NATO-ja, përmes KFOR-it, mbulonte fushën e sigurisë. UNMIK- u në nëntë vitet e para të mandatit të tij në Kosovë krijoi një sistem unik politik, juridik, gjyqësor, financiar, monetar, doganor, arsimor dhe medial që i ngjante më tepër qeverisjes ndërkombëtare sesa administrimit territorial ndërkombëtar apo protektoratit. Si i tillë, ishte model i parë në praktikën e OKB-së. Duke vepruar gjatë atyre nëntë vjetëve edhe si pushtet legjislativ, PSSP-ja promulgonte rregulloret që kishin fuqinë e ligjit, udhëzimet administrative etj., e nga viti 2001 edhe Kornizën Kushtetuese. (Blerim Reka)

MITA Jak (1929-2005). Gazetar, përkthyes. Lindi në Prizren. Shkollën fillore dhe gjysmëmaturën i kreu në vendlindje, ndërsa shkollën normale në Gjakovë. Në vitin 1949 nis studimet për letërsi në degën e albanologjisë në Fakultetin Filozofik të Beogradit. Nga viti 1953 punoi mësimdhënës në Shkollën Normale në Prishtinë, ndërsa pas dy vjetësh largohet nga puna si “i papërshtatshëm” dhe detyrohet të kthehet në Prizren. Pas një kohe sërisht vazhdoi punën si mësimdhënës në këtë qytet. Rikthehet në Prishtinë redaktor i radiodramës në gjuhën shqipe në Radio Prishtinë, ku punoi

deri në vitin 1970. Po në këtë kohë emërohet kryeredaktor i revistës shkencore "Përparimi". Përktheu vepra të ndryshme të autorëve të huaj nga serbokroatishtja në gjuhën shqipe. Mbas vitit 1990 angazhohet për themelimin e Shoqatës humanitare bamirëse "Nënë Tereza" në Prishtinë. Në krye të kësaj organizate qëndroi deri në fund të jetës. (Ibrahim Berisha)

MITOLOGJIA POPULLORE. Është tërësia e miteve dhe e gojëdhënave popullore me zanafillë nga kohë të lashta. Tregimet mitike pasqyrojnë elemente kulturore të periudhave të ndryshme të bashkësisë primitive dhe e kanë burimin te kushtet e një niveli të ulët të zhvillimit të forcave prodhuese dhe të njohjes së fenomeneve dhe, si rrjedhojë, pasqyrojnë edhe pafuqinë e njeriut kundrejt natyrës. Mitologjia është pjesë e çdo feje. Ndërkaq, mitet që e vazhdojnë jetën si pjesë e kulturës popullore ruajnë dëshirat dhe përpjekjet e hershme të njeriut për të sunduar natyrën, sikundër që ruajnë edhe gjurmë të ndryshimeve historike-shoqërore etj. Dhe, gjithashtu, shërbejnë edhe si bazë e folklorit.

Mitologjia popullore shqiptare pasqyron rrugën e zhvillimit etnokulturor të këtij entiteti. Ajo e ka burimin te mitologjia ilire dhe pasqyron marrjet e dhëniet e ilirëve me popujt fqinjë të lashtësisë. Ka arritur në ditët tona e shkrirë, e copëzuar dhe e shndërruar në krijimtarinë popullore, në folklor, në artin e zbatuar dhe besimet popullore. Kulti totemik i gjarprit tek ilirët është ruajtur edhe në mitologjinë popullore shqiptare. Me kultin e të parëve janë lidhur mitet që flasin për vitoren, për hijet e shpirtrave të vatrës, për nënën e vatrës, për kuçedrën, orën etj. Ndër mitet që lidhen me natyrën dhe kafshët e egra, spikat figura e Zanës me atributet e saj, dhia e egër, drenusha, zogu, që janë dokumentuar si tek ilirët, ashtu edhe ndër shqiptarët. Një vend të gjerë zënë mitet që lidhen me prodhimin dhe mirëqenien, me bujqësinë e blegtorinë, me kultin e tokës dhe të trupave qiellorë. Dielli si simbol i jetës, i shëndetit, i mirëqenies dhe i prodhimit del shpesh në mitet shqiptar. Një numër syresh lidhen me ritet vjetore të prodhimit bujqësor e blegtoral, me kremtet, si: Dita e Verës, e Shëngjergjit, Nata e Buzmit etj. Mitet, ritet dhe besimet e burimit pagan të mitologjisë sonë janë të sinkretizuara me

elemente dhe me dukuri të religjioneve monoteiste, sikundër ndodh edhe te popujt e tjerë. Dukuritë mitologjike i vërejmë në ndërtimin dhe trajtimin e banesës, në mënyrën e të ushqyerit tradicional, në veshje dhe shtrojë, në bujqësi, në blegtori, në zeje dhe mjeshtri të ndryshme, në kremte të motmotit, rite dhe besime në totemet e ndryshme, në male, shpella, ujëra, drunj të veçantë shekullorë, në hyjni pagane dhe heronj kulturorë të lashtësisë. Mitologjia popullore shqiptare është pjesë e pasurisë së lashtë kulturore, me tiparet e veçanta etnike. Me studimin e saj janë marrë disa studiuës shqiptarë dhe të huaj. (Bashkim Lajçi)

MITROVICA. Qytet në skajin verior të Rrafshit të Kosovës, njëra nga shtatë qendrat më të mëdha rajonale të Kosovës. Shtrihet rrëzë kupës vullkanike të Zveçanit, midis lumenjve



MITROVICA

Ibër dhe Sitnicë. Kufizohet me shpatet e Kopaonikut, Rogoznës e Çiçavicës. Është qendra kryesore e rajonit verior të Rrafshit të Kosovës. Pozita gjeografike e përshtatshme dhe pasuritë e shumta nëntokësore kanë mundësuar popullimin e hershëm të këtij qyteti. Dëshmi për vjetërsinë e vendbanimit janë gjetjet e shumta arkeologjike në Mitrovicë dhe rrethinën e saj. Në fshatin Zhitkoc, në tarracën buzë lumit Ibër, është zbuluar një lokalitet i periudhës së neolitit të hershëm. Në territorin e qytetit, në vendin ku sot është fabrika kimike, është zbuluar një lokalitet i madh nga periudha e neolitit të vonshëm. Mitrovica e sotme, si vendbanim, ka filluar të ndërtohet nga fundi i shekullit XIII dhe fillimi i shekullit XIV. Ajo e ka marrë emrin sipas kishës së Shën Dhimitrit. Nga mesi i shekullit XIV, në një dokument

raguzan, ky vendbanim është shënuar si De Dimitrovic, por nga fundi i shekullit XV ajo paraqitet edhe si Mitrovica. Bërthama e qytetit u formua në bregun e djathtë të lumit Ibër dhe të lumit Lushtë. Për shkak të pozitës së rëndësishme komunikuese, në udhëkryqin e rrugëve të shumta, ajo shumë shpejt bëhet qendër ekonomike e rrethit. Kohëve të fundit qyteti u zgjerua në anën e majtë të lumit Ibër, në drejtim të Zveçanit. Kjo pjesë e qytetit është e re, me objekte të larta, me fizionomi të një qyteti bashkëkohor. Në të shkuarën Mitrovica shërbente si qendër e karvanëve në rrugën që lidhte vendbanimet e vjetra, Zveçanin dhe Trepçën. Si vendbanim me 15 shtëpi, përmendet në defterin turk të vitit 1455. Në defterin e përgjithshëm të sanxhakut të Bosnjës (1604), në kuadër të nahisë së Zveçanit, ajo është e regjistruar me emrin Dimitrovica dhe kishte 4 mëhallë. Ipeshkvi Pjetër Bogdani në mars të vitit 1684, duke shkruar mbi gjendjen në Kosovë, për Mitrovicën shkruante: “vend me 500 shtëpi, 3 orë rrugë larg Vushtrrisë, është e vendosur në fushë dhe duket si akrep sahati”. Shekulli XIX njihet si periudha më e rëndësishme e zhvillimit të saj, me ringjalljen e tregtisë dhe me ndërtimin e linjës hekurudhore Shkup-Mitrovicë, me çka ajo bëhet stacion i rëndësishëm i këmbimeve në drejtimin Selanik-Sanxhak. Gjatë periudhës së Mbretërisë Jugosllave, popullsia shqiptare i nënshtrohet presionit dhe dhunës, prandaj një numër i konsiderueshëm i banorëve shpërngulet për në Turqi. Sipas regjistrimit të vitit 1913, Mitrovica kishte 9,354 banorë, kurse në vitin 1923 kishte 2,178 shtëpi me 10,000 banorë. Gjatë vitit 1931 filloi eksploatimi i xehes së plumbit në Trepçë. Nga ajo kohë Mitrovica bëhet qendër e njohur industriale e Kosovës. Pas Luftës së Dytë Botërore, Trepça e dikurshme, e njohur si qendër e shfrytëzimit të mineralit të plumbit dhe të zinkut, shndërrohet në kombinat xehetaro-metalurgjik, në kuadër të të cilit hyjnë shkretorja dhe rafineria, elektroliza e zinkut, industria kimike e superfosfateve, fabrika e akumulatorëve, e llamarinës së zinkut dhe flotacioni në Stantërg. Zhvillimi i industrisë dhe i degëve të tjera ekonomike solli deri te rritja e numrit të popullsisë. Sipas regjistrimit të vitit 1953 Mitrovica kishte 17,150 banorë, në vitin 1971 arrin në 42,241 banorë, në vitin 1981 në Mitrovicë jetonin 52,761 banorë, ndërsa në regjistrimin e fundit numëronte 58,458 banorë.

Sot në qytetin e Mitrovicës funksionojnë institucionet arsimore prej nivelit parashkollor deri në atë universitar. Shërbime shëndetësore ofron spitali i përgjithshëm dhe disa qendra të mjekësisë familjare. (Nazif Gashi)

MITROVICA (komuna). Komunë në pjesën veriore të Kosovës. Shtrihet në skajin verior të Rrafshit të Kosovës, duke përfshirë pjesën e zonës malore të Kopaonikut, shpatet e Rogoznës, Moknës dhe Çiçavicës. Sipërfaqja e territorit të komunës është 336.2 km². Në veri kufizohet me komunën e Zveçanit, në verilindje me komunën e Podujevës, në jug me komunën e Vushtrrisë dhe në perëndim me komunën e Zubin Potokut. Nëpër territorin e komunës kalojnë dhe kryqëzohen rrugë të rëndësishme që çojnë në brendësinë e Gadishullit Ballkanik, në drejtim të detit Adriatik, të detit Egje dhe të Detit të Zi. Dominon relievi malor, i cili e përcakton fizionominë e kësaj hapësire. Klima është e mesme kontinentale, me temperaturë mesatare vjetore prej 10.4°C, që është e ngjashme me atë të Anamoravës së Kosovës. Një anomali e tillë lidhet me barrierën malore nga veriu, e cila pengon depërtimin e erërave të ftohta në drejtim të kësaj zone. Temperatura mesatare e dimrit është 0.7°C, e verës 20.0°C, ndërsa temperatura e ajrit në periudhën vegetative është 16.7°C. Sasia mesatare e reshjeve në Mitrovicë është 658 mm, ndërsa me rritjen e lartësisë mbidetare sasia e reshjeve shtohet deri në 890 mm në Bare. Rrjetin hidrografik të kësaj komune e përbëjnë lumenjtë: Ibri, Sitnica, Lushta dhe lumi i Trepçës. Ibri është arterie kryesore hidrografike, që i jep gjallëri kësaj ane, duke sjellë sasi të konsiderueshme të ujit, si për ujitjen e tokave, gjithashtu edhe për pije dhe për nevoja të industrisë. Në aspektin biogeografik, pjesa më e madhe e territorit të komunës së Mitrovicës është e mbuluar me pyje dhe kullosa të përshtatshme për blegtori. Pjesa jugore e komunës është fushore, kryesisht rreth lumit Sitnica, me kushte të volitshme për zhvillimin e bujqësisë.

Pozita e volitshme natyrore dhe gjeo-komunikative e Mitrovicës ka mundësuar popullimin e hershëm të kësaj treve. Masivi malor i Kopaonikut dhe Trepça, të pasura me resurse minerale, kanë ndikuar në përqendrimin e popullsisë në këtë hapësirë. Që në antikitet janë eksploatuar pasuritë xeherore të kësaj zone. Pushtimet e njëpasnjëshme sollën ndryshime të

rëndësishme edhe në rrafshin demogjeografik. Në territorin e komunës së Mitrovicës pas vitit 1887 vendoset një pjesë e popullsisë shqiptare e përndjekur nga sanxhaku i Nishit, kryesisht në fshatrat: Frashër, Kaçanoll, Kçiç, Shipol, Suhadoll i Poshtëm, Vaganicë, Vërnice dhe Zhabar i Epërm. Në këtë periudhë vendosen edhe një numër i banorëve boshnjakë, të ikur nga Bosnja e Hercegovina, e cila në atë kohë ishte aneksuar nga Austro-Hungaria. Me ripushtimin e Kosovës më 1913, për shkak të shpërnguljes së shqiptarëve ndodh edhe ndryshimi i strukturës etnike-demografike. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, për shkak të Trepçës, zona e Mitrovicës vendoset nën administrimin gjerman. Pas Luftës së Dytë Botërore vazhdon përndjekja dhe shpërngulja e shqiptarëve në Turqi. Me zgjerimin e autonomisë së Kosovës (1974), Mitrovica me rrethinë përjeton ndryshime të rëndësishme ekonomiko-shoqëror. Pas luftës së fundit të vitit 1999, popullsia shqiptare dëbohet në masë, për t'u kthyer disa muaj më vonë në shtëpitë dhe pronat e tyre. Po në këtë kohë popullsia shqiptare dëbohet nga pjesa veriore, ndërsa ajo serbe nga pjesa jugore e Mitrovicës. Kështu, lumi Ibër e ndan qytetin në baza etnike, në pjesën veriore të populluar kryesisht me serbë dhe pjesën jugore të banuar me shqiptarë. Arsimi në komunën e Mitrovicës zhvillohet paralelisht me ndryshimet politiko-shoqërore dhe me zhvillimin ekonomik të kësaj treve. Në dekadat e fundit të shekullit XX, arsimi përjeton një transformim të vërtetë, veçmas me hapjen e disa fakulteteve të Universitetit të Prishtinës, kryesisht të degëve teknike dhe xehetare-metallurgjike. Sot Mitrovica është qendër universitare. Edhe organizimi i mbrojtjes shëndetësore në Mitrovicë ka një traditë relativisht të gjatë: spitali i përgjithshëm punon që nga viti 1938. Në territorin e komunës së Mitrovicës janë gjithsej 48 vendbanime. Sipas regjistrimit të popullsisë në vitin 1991 (vlerësim), komuna e Mitrovicës kishte 110,310 banorë, ndërsa regjistrimi i 2011 nuk u bë në tërë komunën, për shkak të ndarjes së qytetit. (Nazif Gashi)

MITROVICA Rexhep (1888-1960). Publicist, diplomat, pjesëmarrës në Kuvendin e Pavarësisë në Vlorë (1912), kryeministër i Shqipërisë i shpallur nga Këshilli i Lartë i Regjencës (1943), kryetar i Lidhjes së Dytë të Prizrenit. Lindi në Mitrovicë, shkollën fillore në gjuhën turke e kreu në vendlindje, më pas në Selanik kreu



REXHEP
MITROVICA

liceun turk dhe vazhdoi studimet e larta për drejtësi dhe letërsi në Paris. Pas vdekjes së të atit i ndërpreu studimet dhe u kthye në Shkup, ku drejtoi një shkollë profesionale. Më 1910 mori pjesë në Kongresin e Dytë të Manastirit, drejton gazetën “Bashkimi i Kombit”, të cilën e botonin intelektualët shqiptarë të Shkupit. Ishte delegat i Kosovës në Kuvendin e Vlorës (1912) dhe firmosi aktin e Pavarësisë së Shqipërisë. Anëtar i Senatit dhe ndihmësm ministër i Punëve të Jashtme. Në qeverinë e Princ Vidit drejtor i arsimit për qarkun e Elbasanit. Më vonë shkon në Vjenë ku vazhdon studimet në pedagogji dhe në mësimdhënie. Pas mbarimit të studimeve (1920), punon si mësues. Në parlamentin e parë të Shqipërisë, pas Kongresit të Lushnjës, u zgjodh deputet i prefekturës së Kukësit dhe në kabinetin qeveritar të kryesuar nga Xhafer Ypi, mori detyrën e ministrit të Arsimit (1921-1924). Bëri reformimin e sistemit arsimor dhe vuri themelet e zhvillimit të arsimit shqiptar. Pas Revolucionit të Qershorit, (1924) mërgoi jashtë shtetit. Gjatë Luftës së Dytë Botërore veproi në Shqipëri dhe në Kosovë, së bashku me Xhafer Devën, Xhelal Mitrovicën, Bedri Pejanin etj. U ngrit kundër pushtimit italian dhe u burgos prej tyre në verën e vitit 1943. U lirua nga burgu i Porto-Palermos pas kapitullimit të Italisë. Në shtator të po atij viti u zgjodh kryetar i Komitetit Qendror të Lidhjes së Dytë të Prizrenit dhe një muaj më vonë, nga Këshilli i Lartë i Regjencës, emërohet kryeministër i Shqipërisë (tetor 1943 - maj 1944). Nga gjysma e nëntorit e vitit 1944 emigron një herë në Zagreb dhe pastaj në Austri. Për arsye shëndetësore qëndroi në Austri deri në vitin 1947, pastaj migroi në Itali dhe që andej në Turqi. Vdiq në Turqi. (Daut Bislimi).

MITROVICA Rexhep (1959-). Aktor. Lindi në Francë. Është nipi i ish-ministrit të Arsimit dhe ish-kryeministrit të Shqipërisë po me këtë emër. Fillimisht u formua në “Théâtre blanc” nga Gérald Robard, pastaj në “Théâtre du miroir” nga Daniel Mesguich, si dhe nga Antoin Vitez dhe Madelaine Marion. Studioi në Konservatorin e Lartë të Artit Dramatik nën kujdesin e Claude Régy. Konsiderohet

REXHEP
MITROVICA

një nga figurat më të rëndësishme të teatrit francez. Në festivalin e Avignon-it, regjisori i njohur Vitez i besoi rolin e Hernanit në shfaqjen “Këpucët e djallit”, para se t’i ofronte rolin e Orestit në versionin e tij të “Elektrës”. Roli i tij në dramën e Brehtit, “Jeta e Galileut” do t’ia hapë dyert e Teatrit Kombëtar të Komedisë Franceze, ku, nën kujdesin e Daniel Mesguich-it, do të luajë role të rëndësishme në “Mbreti Lir”, “Makabri i madh”, “Devocioni dhe kryqi” etj. Si aktor i Teatrit Kombëtar të Komedisë Franceze luajti role të rëndësishme, si Hamletin, Lorenzaccio, me të cilin fitoi çmimin “Molière de la Révélation théâtrale”. Interpretoi pastaj role të rëndësishme në shfaqjet “Elektra”, “Don Zhuan” etj. Përveç teatrit është angazhuar edhe në shumë filma si: “Agimi” (1986), “Një notë blu” (1991), “Pak para shtrëngatës” (1992), “Instinkti i engjëllit” (1993), “Një ajër aq i pastër” (1996), “Të zhdukurit” (1998) etj. Kritika franceze e cilësoi si aktor me potencial të lartë artistik, me timbër, portret dhe plastikë tejet ekspresive. Në vitin 1995 për herë të parë e vizitoi Shqipërinë, ndërsa më 1996 bëri leximin publik të veprave “I dënuar me vdekje”, “Marshim i përmortshëm” dhe “Këngë dashurie” të autorit Jean Genêt. Jeton dhe vepron në Francë. (Emin Emini)

MJAKU Bajrush (1952-). Aktor. Lindi në Kačanik. Studimet për aktrim i mbaroi në Fakultetin e Arteve në Universitetin e Prishtinës (1975). Në vitin 1973 filloi punë si aktor në trupën e



BAJRUSH MJAKU

Teatrit të Kombësive në Shkup. Është aktor i një game të gjerë stilesh dhe zhanresh, ku dominon një qasje groteske dhe ekspresioniste. Përveç angazhimit në Teatrin Shqiptar të Shkupit, B. Mjaku aktroi edhe në teatro të tjera, si në Maqedoni, Kosovë, Suedi, Kroaci etj. Nga rolet e shumta (kryesisht role kryesore) veçohen: Zyrtari i lartë në “Eshtat vijne vonë”, Liri në “Mbreti Lir”, Pikoni në “Shi në Uortemonto”, Baali në “Baal-i”, Tartufi në “Tartufi”, Kapiteni

në “Babai”, Leni Smol në “Minjtë dhe njerëzit”, Macua Basho në “Bovça”, Mate Potera në “Hamleti në Katranicën e poshtme”, Andrea Temlin në “Sauna”, Emanou në “Varrezat e automobilave”, Karlo V në “Dielli po perëndon”, Babai në “Nesër nisemi për parajsë”, Vojnicki në “Daja Vanja”, Gynti në “Per Gynt”, Sokrati në “Vdekja e Sokratit”, dr. Stokmani në “Armiku i popullit” etj. Si pjesëmarrës në një sërë festivalesh ndërkombëtare, ishte fitues i shumë çmimeve si aktori më i mirë. Prej roleve të tij më të realizuarat dallohen: Baal-i në dramën “Baal-i” e Bertold Brehtit (1992) në regji të B. Brezovacit, rol me të cilin është shpallur aktori më i mirë në disa festivale. Por fuqia e tij shprehëse prej aktori u manifestua sidomos në monodramat “Ditari i një të çmenduri” e Gogolit, (2011) me të cilën mori pjesë në disa festivale dhe kompeticione teatrore kombëtare e ndërkombëtare, si dhe me rolin e Sokratit në “Mbrojtja e Sokratit” (2012), rol për të cilin u shpall aktori më i mirë në Festivalin Ndërkombëtar të Tatrit Kamertal në Strumicë të Maqedonisë. Pos në teatër, realizoi role edhe në seriale dhe filma televizivë, si në “Trieste via Shkup”, “Zoti i vraftë spiunët”, “Lulepjeshkat e dashurisë”, “Kulla”, “Rropullari”, “Librat e babait” dhe në filmat artistikë: “Hakmarrja”, “Iluzioni”, “Mirushja”, “Aguns Dei” etj. Gjatë viteve 1980-1990 dhe 2003-2004 ishte drejtor artistik i Teatrit Shqiptar të Shkupit. Është njëri prej themeluesve dhe drejtor i produksionit të Qendrës Teatrore për Fëmijë në Shkup. (Fadil Hysaj)

MJEDJA Imzot Lazër (1869-1935). Titullar i Kishës Katolike, argjipeshkëv. Lindi në Shkodër, shkollimin e filloi dhe e përfundoi në Seminarin Papnor në Shkodër (1891). Për




LAZËR MJEDJA

shugurimin e tij si prift në moshën 21-vjeçare dha leje vetë papa, meqë nuk lejohej shugurimi si prift pa e arritur moshën 24 vjeç. Edhe emërimi dhe shugurimi i tij ipeshkëv i Sapës, në moshën 31-vjeçare (ndërsa kërkohej moshë 45 vjeç), janë raste të rralla në historinë e kishës. Ndërkaq, në vitin 1905 Selia e Shenjtë e përuroi ndihmës të argjipeshkëvit të Shkodrës. Si ipeshkëv i ri u angazhua në hapjen e shkollave dhe në botimin e librave dhe të revistave. Ishte

ndër themeluesit e Shoqërisë “Agimi”, e cila dha një kontribut të çmuar për gjuhën dhe alfabetin shqip. Nevoja për një argjipeshkëv në Shkup, pas largimit të imzot Trokshit, e sollën L. Mjedjen në krye të kësaj argjipeshkëvie. Gjatë punës në Argjipeshkëvinë e Shkupit përjetoi ngjarje të rënda, si të besimtarëve, ashtu edhe të mbarë popullit shqiptar. Bashkë me dom Zef Ramajn, famullitar në Shkup, përmes konsullatave të huaja, sidomos të asaj austro-hungareze, u përpoqën të sensibilizonin opinionin europian për gjendjen e shqiptarëve, gjatë luftërave ballkanike dhe pas tyre. Po me këtë qëllim botuan edhe një sërë tekstesh në shtypin austriak. Ishte aktiv edhe në zhvillimet rreth shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë. Rrethanat e reja politike dhe vdekja e imzot Guerrinit bënë që L. Mjedja të transferohej në Shkodër (1921), ku shërbeu deri në fund të jetës. (Sarë Gjergji)

MJEDA Veronika (1938-). Violiniste, këngëtare, mësimdhënëse. Lindi në Prizren, ku kreu Shkollën e Ulët dhe të Mesme të Muzikës (1956). Akademinë e Muzikës e regjistroi në Beograd dhe e kreu në Shkup (1980). Ishte mësimdhënëse në Shkollën Normale, më vonë në Shkollën e Muzikës në Prizren. Një vit ishte udhëheqëse e korit të Shoqërisë kulturore-artsitike “Agimi”. Nga viti 1963 punoi në Shkollën e Muzikës në Prishtinë, mësimdhënëse e violinës dhe e solfezhit. Një kohë të gjatë ishte anëtare e korit “Collegium Cantorum”. Si soprano, ishte ndër të parat që vunë në skenë kantatën “Poema për ata” të R. Mulliqit. Në vitet ‘90, në rrethanat e mësimt në shtëpi private, ishte ndër vullnetaret që e lëshoi shtëpinë për mbajtjen e mësimt për disa breza. Pas luftës u angazhua për hapjen e Shkollës së Muzikës në Ferizaj, ku punoi deri më 2003. U pensionua dhe u angazhua në udhëheqjen e Korit të fëmijëve “Pjetër Bogdani” në Famullinë Shën Ndou në Prishtinë. (Kristina Palokaj-Përkola)

MJEDJA Ndre (1866-1937). Poet, gjuhëtar, përkthyes, prift katolik, veprimtar kombëtar. Lindi në Shkodër. Ndoqi mësimet private në Shkodër dhe më pas i vijoi në seminarët jezuite të Provincës Veneta nga Laval (Francë), pastaj në seminarin pranë Portones (Kraoci) dhe në seminarin pranë Chierit (Itali). Më 1888 vijoi të studiojë në Kolegjin Vida në Cremona (Itali), ku kreu edhe katër vjet praktikë pedagogjike. Nga



NDRE MJEDJA

1891-1893 vijoi studimet teologjike në degën e Universitetit Gregorian të Romës në Krakovë (Poloni), e në vitet 1893-95 ndoqi studimet në Gorizia (Itali), ku ishte edhe lektor i shqipes. Më 1895 mori kungimin e priftit dhe shpallet atë i Shoqërisë Jezuite. Deri në 1898 punoi profesor i logjikës e metafizikës në “Colegium Portoregiense” (Fiume, Kroaci). Më 1898 N.Mjedja doli nga Shoqëria e Jezuitëve dhe qëndroi në Itali deri në fund të vitit 1898. Pasi u kthye në atdhe shërbeu si famullitar në Vig (1889-1901). Ndërkohë, u ftua në shoqërinë “Bashkimi”, e pas kontradiktave me anëtarët e tjerë për çështje të alfabetit, më 1901, bashkë me të vëllanë, Lazër Mjedjen, themeloi shoqërinë “Agimi”, e cila propozoi një alfabet me shenja diakritike. Në tetor të vitit 1902, sapo ishte kthyer nga Kongresi i Orientalistëve që u mbajt në Hamburg u arrestua nga qeveria osmane për përfshirjen e tij në veprimtari politike, por ndërhyrja austro-hungareze e shpëtoi prej mërgimit. Në vitet në vijim ishte sekretar e ndihmës i Lazër Mjedës në Ipeshkëvinë e Sapës. N.Mjedja shërbeu si famullitar në Kukël nga viti 1907 deri më 1930. Më 1908 në Kongresin e Manastririt u zgjodh anëtar i komisionit për hartimin e alfabetit dhe propozoi kompromisin që çoi në suksesin e këtij Kongresi, duke u tërhequr prej alfabetit të tij me shenja diakritike. Më 1912 u arrestua sërish nga autoritetet turke. Që nga viti 1916 ishte anëtar i “Komisijës letrare shqipe”, organizëm me ndikim të madh në krijimin e themeleve të një koineje të përbashkët shqipe. Në vitet 1920-1924 ishte deputet asamblist i Shkodrës në Kuvendin Kombëtar, pjesëtar i opozitës dhe përfaqësues i grupit “Ora e maleve”, ku u shqua për kontributin e tij si hartues e shkruer i disa ligjeve. Nga viti 1930 e derisa vdiq ligjëroi në Kolegjin Jezuit të Shkodrës. N.Mjedja filloi të botojë poezi që në moshën 22-vjeçare: “Shahiri Elierz” (Shkodër, 1888), “Andërr” (poezi, Selanik, 1909), vëllimi “Juvenilia” (Vjenë 1917, Shkodër 1928); “Lissus” (poemë, “Hylli i Dritës”, 1921), poema “Lirija” (Shkodër, 1937), poema tingëllimore “Scodra” (Shkodër, 1939). Më pas botoi poezi në gazeta dhe revista të kohës dhe në përmbledhje të ndryshme. Disa poezi u botuan edhe pas vdekjes së tij. Vepra e plotë e N.

Mjedjes me titullin “Juvenilia dhe vepra të tjera” u botua në Tiranë në vitin 1964. Në poetikën e N.Mjedjes vetmia bëhet temë e poezive si “Vaji i bylbylit”, “Malli për atdhe”, “Shtegtari”, “I tretuni” etj., që e zbulojnë duke e krijuar qenien njerëzore, ankthin, dëshpërimin e dashurinë. Kënga e vaji për lirinë shkruhen jo vetëm si liri kombëtare (“Lirija”), por edhe si etikë e estetikë e jetës, edhe si komunikim me vetveten. Topika e vdekjes, e shfaqur që në poezitë “Në dekë të shoqit tim G.S”, “Vera”, “Vjeshta” etj. bëhet vatra kuptimore e jetës në harmoni me natyrën e me Zotin dhe përvijohet si thelb i pashmangshëm i së vërtetës njerëzore e hyjnore tek “Andra e jetës”, kryevepra poetike e Mjedjes. Në këtë poemë filozofike përmes vargësh polimetrike krijohen fragmentet e mozaikut të një jete (me tri pamjet e stinët e saj, “Tringa”, “Zoga” e “Lokja”), të një ëndrrë e të vdekjes, ligjësi e pashmangshme e gjithësisë. Kërkimi i së bukurës si sistem e proporcion zbulohet në dialog me natyrën si peizazh e alegori ndodhish njerëzore. Ndërsa shkrimi mitik e lapidar i historisë poetike të kombit merr trajta klasike në poemat “Lissus” e “Scodra”, pjesë të projektit të N.Mjedjes për rithemelimin e identitetit shqiptar, si dhe trajta kushtrimi te poezitë “Shqypes arbnore”, “Bashkonju”, “Vorri i Skanderbegut” etj. Forma e përsosur poetike, pasuria metrike e figurative dhe kërkimi pa skaj i përsosmërisë e bëjnë shkrimin e N. Mjedjes model rrezatues të lirikës shqipe. Përveç poezive, shkroi dhe përktheu edhe prozë me karakter fetar. Edhe interesimi i N. Mjedjes për gjuhën e gjuhësinë është i hershëm dhe vazhdoi gjatë gjithë jetës, duke u lidhur me nevojën e poetit për të hetuar e shtyrë kufijtë e gjuhës si mundësi njohjeje e shkrimi. Studimet gjuhësore të tij përfshijnë një numër shkrimesh mbi alfabetin e shqipes, mbi dialektet, pastaj studime etimologjike dhe onomastike, përfshirë edhe transkriptimin e autorëve të letërsisë së vjetër shqipe. Studimet gjuhësore N. Mjedjes i kombinonte edhe me përpjekjet si pedagog e didakt në hartimin apo përshtatjen e një serie librash për shkollat fillore të botuara me alfabetin e Shoqërisë “Agimi”, të gjitha të botuara në Vjenë në periudhën kohore 1904-1906. Në këtë seri botimesh janë përfshirë edhe poezitë për fëmijë të N. Mjedjes. Ndërsa shkrimet kritike e teorike mbi artin letrar, teorinë e praktikën e përkthimit që vijnë pas përvojave më të hershme të tij prej përkthyesi e përshtatësi janë botuar në vitet ’30, kryesisht

te revista “Leka”, ndërsa traktati estetik “Përmbi poezi përgjithësisht”, i mbetur në dorëshkrim, u botua vetëm më 1941 në revistën “Shkëndija”. (Dhurata Shehri)

MJEKËSIA MESJETARE. Mjekësia praktike në Kosovë, sidomos në shek. XI-XV është zhvilluar paralelisht, krahas mjekësisë bizantine dhe të asaj perëndimore. Mjekësia që zhvillohej në Kosovë ishte ajo e Hipokratit, Galenit etj. Mjekësia klinike e Hipokratit ishte nën ndikimin e mjekësisë religjioze, pa ndonjë zhvillim të anatomisë dhe të fiziologjisë. Ndërhryjet kirurgjike kufizoheshin vetëm në kirurgji të thjeshtë, me trajtimin e lëndimeve, frakturave, me prerjen e abscesit, herniotomi dhe ndonjëherë bëheshin edhe trepanacione. Në të shumtën e rasteve, për shkak të infekcionit dhe mosqepjes së plagës, operacioni përfundonte me vdekje. Situatë identike ishte edhe në gjinekologji. Pas çdo lindjeje të vështirë, lehnës i shuhej jeta, si pasojë e sepsës.

Në shek. XIV-XV të gjitha epidemitë e mur-tajës vinin në Europë nga Azia e Vogël dhe kryesisht përmes detit. Në Ballkan kjo epidemi me përmasa të mëdha u shfaq në vitin 1347/8, e cila mbyti shumë njerëz edhe në Kosovë: Novobërdë, Prishtinë, Trepçë etj. (1456, 1457 e 1466). Një sëmundje mjaft e përhapur ishte gërbula (lepra), e njohur nga fillimet e shek. XIII. Të sëmurët që lëngonin nga gërbula përmenden në spitalin e Manastirit të Deçanit. Të sëmurit nga gërbula dëshmohen edhe në krisobulën e shenjtorëve Mëhill e Gabriel në Prizren (1348).

Në rrethanat e përgjithshme shëndetësore mesjetare, rol me rëndësi kanë pasur kushtet higjienike. Nga objektet e higjienës në qytetet e Kosovës mesjetare janë ruajtur cisterna ujëmbledhëse në Prizren, Novobërdë, Trepçë etj. Cisterna e Prizrenit, që është ruajtur deri në ditët e sotme, shërben si rezervuar për ujë dhe gjendet në kalanë e qytetit. Me ardhjen e osmanëve dhe ngritjen e hamameve, në shumë qendra kosovare u bë përparim i dukshëm në këtë aspekt. Në spitalin e Manastirit të Deçanit gjenin strehim edhe të sëmurët nga epilepsia, tuberantët, reumatikët dhe leprozët. Në spitalin e Prizrenit, te Manastiri i Shenjtorëve Mëhill e Gabriel, përveç të sëmurëve nga gërbula, gjenin strehim edhe të sëmurët e tjerë. Janë të njohur edhe spitalet pranë kishave dhe kuvendeve katolike, si dhe në qytete, siç

ishte Novobërda etj. Për shërbime mjekësore shquheshin sidomos mjekët bizantinë, italianë dhe vendësit abërorë. Mjeku i parë nga Kosova, i dëshmuar në burime historike, ishte Milicius de Presarin, i njohur në fushën e urologjisë. Përveç tij, në Prizren e ndeshim edhe mjekun Abedin Zeneli, i dëshmuar sipas një mbishkrimi në Xhaminë e Sinan Pashës në Prizren (1608). Dokumentet e viteve 1339-1340 dëshmojnë për zhvillimin e farmacisë në Prishtinë, ku përmendet një farmacist i quajtur Zanini. Gjatë viteve 1836-1856 në Prizren janë shitur ilaçe farmaceutike nga Haxhi Durmishi. Barnatoret e para profesionale në Kosovë janë të njohura në Prishtinë dhe në Prizren (1885). (Jahja Drançolli)

MJEKËSIA NË KOSOVË. Të dhënat mbi zhvillimin e mjekësisë në trevat shqiptare në lashtësi, në Iliri dhe Dardani, vijnë nga burimet historike, monumentet e shkruara (mbishkrimi-



QENDRA KLINIKE UNIVERSITARE E KOSOVËS

met, monedhat, aktet, shkrimet, recetat), gojëdhënat, mitet si dhe nga zbulimet arkeologjike, si elementë kirurgjikalë, enë qeramike, peshore farmaceutike, disa lloj lugësh të holla kocke ose bronzi, bimë mjekësore apo pjesë trupi të gdhendura në gurë apo varre, që flasin për një mjekësi të kohës.

Në lashtësi mjekësia pati karakter magjik dhe mitologjik. Ishte "shpirti i keq" apo "qoftëlargu" që futej në trupin e njeriut dhe shkaktonte sëmundjen, apo "syri i keq" që "shitontë". Mjekët e parë në Dardani ishin priftërinjtë paganë. Sipas Theofrastit, Diskoridit e Galenit, dardanët njihnin dhe përdornin shumë bimë mjekësore, mes tyre Iris Illyrica, Gentiana (bari i zëmrës), por njihnin, përdornin dhe tregtonin rreth një mijë bimë mjekuese dhe drogeri (Plini V).

Se në Dardani kishte një mjekësi të zhvilluar, dëshmohet nga zbulimet arkeologjike. Në Separantum antik në Pejë u zbulua një altar guri kushtuar hyjnive të mjekësisë, Asklepit, dhe të bijave Higias e Panacesë. Në Prizren është gjetur një monument i këtillë, ku, përveç hyjnive të përmendura, paraqitet një gjarpër i lakuar në shklop. Altarë guri të këtillë janë gjetur edhe në treva të tjera të Dardanisë. Një hyjni tjetër e mjekësisë ilire ishte Medauri, simbol i mjekësisë dhe mbrojtës i qytetit ilir, Rizonit. Gjatë mesjetës, sidomos gjatë shek. XI-XV, praktikohej mjekësia e Hipokratit, Gentit, Galenit dhe e mjekëve të tjerë të njohur antikë, por edhe e mjekëve popullorë. Spitalet e para në Kosovë datojnë nga mesjeta, kryesisht pranë kishave dhe manastireve. Një spital i tillë kishte funksionuar pranë Manastirit të Deçanit dhe një tjetër pranë Kishës së Dy Shenjtorëve në Prizren, që kishte 20 shtretër dhe një barnatore doracake. Ndërkohë, raguzanët ngritën spitalet e veta pranë kishave katolike. Spitali i Novobërdës ishte më i njohuri. Këtu punonin mjekët nga Raguzi dhe Kotorri (1641). Gjatë sundimit osman u ndërtua spitali "Islahana" (Prizren) me 100 shtretër dhe një mjek internist (në gjysmën e dytë të shek. XIX), në Mitrovicë spitali "Hamidije" me 150 shtretër (1872), në Prishtinë spitali me 100 shtretër për nevoja ushtarake turke (1870), në Gjiilan, spitali me 20 shtretër (1895). Mjekët ishin kryesisht turq, por edhe grekë, armenë, shqiptarë, arabë, sllavë etj. Në periudhën 1912-1918, kur Kosova u gjend e pushtuar nga Serbia, për mbrojtjen shëndetësore të popullsisë nuk u ndërmor asgjë me rëndësi. Në vitin 1924 në Prizren hapet Laboratori Bakteriologjik, ndërsa në vitin 1925, me ndihmën e Fondit "Rokfeler", hapet Enti Higjienik-Epidemiologjik në Pejë. Në prag të Luftës së Dytë Botërore Kosova ka pasur gjithsej 390 shtretër spitali, kryesisht për sëmundjet e brendshme, kirurgji dhe sëmundjet ngjitëse. Ndërkaq, profesionin e mjekut në këto vise e kanë ushtruar mjekë vendorë dhe të huaj, në mesjetë të ardhur kryesisht nga Raguzi, Padova, Venediku dhe vende të tjera. Në periudhën e mëvonshme, nga gjysma e dytë e shek. XIX dhe në fillim të shek. XX, në Perandorinë Osmane dolën emra të dëgjuar të mjekëve me origjinë shqiptare, që punuan edhe në trevat shqiptare, si: dr. Besim Omer Pashai (Akalin) nga Çamëria, rektor i Universitetit

të Stambollit, dr. Ibrahim Lutfi pasha, dr. Reuf Angoni, dr. Abdurrahman Kasimati, dr. Murteza Aliu (Strugë), dr. Ibrahim Temo, dr. Fahri Rashidi, dr. Ali Mihali, dr. Behxhet Tezeli, apo Behxhet Mitrovica, dr. Tare Qoftea, internist që punoi në Manastir dhe Kosovë dhe më i hershmi Abedin Zeneli, i cili përmendet që në vitin 1608. Gjithashtu, në Kosovë punuan edhe një numër i mjekëve serbë, boshnjakë, grekë, italianë, gjermanë dhe austriakë, që ishin të vendosur në qendrat më të mëdha urbane të asaj kohe. (Isuf Dedushaj)

MJEKËT PA KUFË (MEDECINS SANS FRONTIERES, MSF). Është organizatë humanitare, joqeveritare dhe fituese e Çmimit Nobel për Paqe (1999). Vepron kryesisht në



NGA VEPRIMTARIA E ORGANIZATËS “MJEKËT PA KUFË”

vatrat e luftës dhe në vendet e zhvilluara, që ballafaqohen me epidemi të sëmundjeve të ndryshme. U themelua në vitin 1971, pas ndarjes së Biafrës (lufta civile në Nigeri), nga një grup i mjekëve dhe gazetarëve francezë, të cilët besonin se të gjithë njerëzit kanë të drejtë për kujdes mjekësor, pavarësisht nga raca, religjioni dhe përkatësia politike. MSF-ja ka strukturë të asociacionit dhe vendimet operative merren të pavarura nga pesë qendra operative: Amsterdam, Barcelonë-Athinë, Bruksel, Gjenevë dhe Paris. Politikat për çështje të rëndësishme ndërkombëtare koordinohen nga Këshilli Ndërkombëtar me seli në Gjenevë të Zvicrës. MSF-ja ofron ndihmë mjekësore dhe trajnime mjekësore në më shumë se 70 shtete. Është i njohur aktiviteti dhe ndihma e jashtëzakonshme e MSF-së në Kosovë dhe Çeçeni. MSF-ja ka vepruar në Kosovë që nga viti 1993 dhe ka mbështetur vaksinimin, furnizimin me ujë,

sanitacionin, furnizimin me barna dhe pajisje mjekësore të ambulancave “Nënë Tereza”. Nga viti 1998, MSF-ja në Kosovë zhvilloi aktivitete emergjente, duke ofruar edhe klinika mobile për popullatën e zhvendosur. MSF-ja u largua nga Kosova më 31 mars 1999, një javë pas fillimit të bombardimeve të NATO-s duke përcjellë refugjatët në vendet fqinje. MSF-ja u kthye në Kosovë më 12 qershor 1999, ku veproi në fusha të ndryshme. U largua nga Kosova në maj të vitit 2000. (Isme Humolli)

MJEKU Bajram (1964-). Gazetar. Lindi në Graboc të Epërm të Obiliqit. Mbaroi studimet për letërsi dhe gjuhë shqipe në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës. Gjatë studimeve punoi në gazetën e studentëve “Bota e re”, ndërsa në vitet 1990-1999 punoi si gazetar dhe redaktor në Qendrën për Informim të Kosovës (QIK). Pas luftës ishte zëdhënës i komunës së Prishtinës dhe më vonë drejtor informacioni në Ministrinë e Punëve të Brendshme të Qeverisë së Kosovës. Shkruan edhe poezi. Botoi librat poetikë “Mashtrimi i Argusit” (1991) dhe “Anija e humbur” (2013). Fitoi disa çmime letrare. (Ibrahim Berisha)

MJEKU Muhamet (1943-). Gazetar. Lindi në Shipitullë të komunës së Obiliqit. Në Prishtinë mbaroi gjimnazin dhe studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe. Një kohë punoi mësimdhënës, ndërsa nga viti 1971 si gazetar në të përditshmen “Rilindja” dhe më pas në Televizionin e Prishtinës (TVP). Ishte redaktor i emisioneve informative në TVP dhe autor i një sërë emisionesh dokumentare. Gjatë grevës së minatorëve të “Trepçës” në vitin 1989 u larguar nga puna për një vit dhe një vit më vonë u suspendua sërish. Në TVP punoi deri në korrik të vitit 1990, kur ky institucion u mbyll nga Serbia. Më pas emigroi në SHBA dhe u përfshi në ekipin e parë të gazetës “Illyria” në Nju-Jork. Është autor i disa librave publicistikë dhe i monografive historike: “Shaban Polluzha dhe Lufta e Drenicës” (1991), “Kosova në dimrin e vitit 1945” (2002), “Vdekja në bunker” (2004), “Një jetë mes Kosovës dhe Amerikës” (2008) etj. Jeton në Nju-Jork. (Ibrahim Berisha)

MOÇI Andrash (Mócsy András) (1929-1987). Arkeolog hungarez, historian, epigraf. I kreu studimet në Universitetin e Budapestit (1949), në latinisht, me fokus në histori dhe



ANDRASH MOÇI

arkeologji. Nga viti 1951 punoi në Muzeun Kombëtar Hungarez dhe drejtoi shumë gërmime arkeologjike në Hungarinë Perëndimore. Në vitin 1959 studioi në universitetin Loránd-Eötvös dhe mbrojti temën e habilitacionit në departamentin e arkeologjisë. Ishte redaktor dhe anëtar editorial i disa revistave kombëtare dhe ndërkombëtare. Spikasin studimet mbi Perandorinë Romake, me fokus në provincat danubiane. Është autor i disa librave, si “Studime mbi provincën romake të Mezisë së Epërme”, “Shoqëria dhe romanizimi në provincën romake të Mezisë së Epërme”, “Panonia dhe Mezia e Epërme” etj. Ishte anëtar i Institutit Arkeologjik të Gjermanisë dhe anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave të Austrisë. U dekorua nga Akademia e Shkencave e Hungarisë (1971), mori medaljen kombëtare hungareze për kulturë (1983), medaljen e artë nga universiteti Loránd-Eötvös etj. (Pleurat Kabashi)

MODELET EKONOMIKE. Një pasqyrim i thjeshtëzuar matematikor, grafik apo tabelar i ndërtuar në një proces abstraktimi për të prezantuar dhe analizuar fenomene të caktuara ekonomike, përkatësisht për t'i bërë të ditura ndërvarësitë e funksionimit të ekonomisë në nivelin makroekonomik apo mikroekonomik. Me qëllim të dhënies së parashikimeve ekonomike, modelet përdoren për të simuluar nga mund të shkojnë zhvillimet lidhur me rritjen ekonomike dhe për çështje të tjera, nën supozimet e skenarëve të ndryshëm të lëvizjes së variablave të ndërvarura dhe në kushtet e supozuara të ndryshimit të rrethanave. Një model matematikor i parashikimit të ekonomisë përdoret në Bankën Qendrore të Kosovës dhe një tjetër po zhvillohet për prognozatat makroekonomike në Ministrinë e Financave. (Muhamet Mustafa)

MOLLA. (*Malus* sp.) Bën pjesë në familjen trëndafilore (*Rosaceae*), nënfamiljen *Pomoideae*. Është pemë gjetherënëse. Plantacionet me mollë në Kosovë zënë një sipërfaqe afro 1, 680 ha (2013). Përhapje kaq e madhe e kësaj kulture është rezultat i një varg faktorësh:



MOLLA

aftësia e mollës për t'iu përshtatur një variacioni të gjerë të kushteve të ndryshme agroklimatike dhe pomoteknike, vlera shumë e lartë ushqyese e këtyre frutave, mundësia e ruajtjes në depo, kërkesat e tregut, arrijta e efekteve të larta financiare etj. Ministria e Bujqësisë dhe organizatat ndërkombëtare, si NOA/USAID-i, Inter corporation kanë ndihmuar në zgjerimin e sipërfaqeve me këtë kulturë. Molla dallohet prej kulturave të tjera pemëtare me një numër shumë të madh të kultivarëve dhe nënshartesave. Kultivarët më të përhapur janë: Idared, Delishesi i artë klon B, Reinders, Melrose, Jonagold, Granny Smith, Gala, Fuji Kiku 8, ndërsa prej nënshartesave janë M 9 dhe MM 106. Kosova ka një numër shumë të madh të kultivarëve autoktonë: molla Vizajke, Gjylja, Lalqe, Shërbete me disa lloje, Kulaqe, Buzli, E kuqja e Prespës, Demirja, Stambollesha, Avajli, e Ponosheci, Laknja, Migjivese, që njëherësh janë pasuri kombëtare dhe mund të shfrytëzohen për përfitim të kultivarëve të rinj. (Agim Zajmi)

MOLLASAT. Seri me trashësi të konsiderueshme të shkëmbinje copëzorë, në të cilën dominojnë konglomeratët, ranorët dhe alevrolitët, më pak qymyrët, gëlqerorët oolitikë dhe evaporitët. Janë formuar në ultësira, pas ngritjes dhe rrudhosjes së vargmaleve, nga materiali i krijuar nga shkatërrimi i tyre. Mollasat janë kryesisht depozitime të ujërave të cekëta dhe materiali për formimin e tyre është sjellë në pellg nga lumenjtë dhe ato shtrohen zakonisht me mospajtim këndor mbi seritë e vërteta gjeosinklinale. Mollasat mund të jenë detare dhe kontinentale. Në Kosovë mollasat kontinentale liqenore, të krijuara gjatë oligocenit, miocenit dhe pliocenit mbushin fushëgropat tektonike (fushat ndërmaalore) të Dukagjinit, të Drenicë, të Kosovës dhe të Moravës së Binçës. Mollasat e fushëgropës së Dukagjinit, me trashësi mbi 2,000 m, të krijuar gjatë miocen-pliocen-kuaternarit, pos shkëmbinjeve tipikë mollasikë përbajnë edhe shtresa të linjtit. Mollosat e Drenicës të moshës pliocenike, me trashësi me të vogël dhe me shtresa të linjtit, ndërsa ato të Moravës së

Binçës, të moshës oligocen-miocen-pliocenike karakterizohen me praninë edhe të produkteve vullkanogjene, magneziteve sedimentare, bentoniteve dhe shtresave të holla të linjtit. (Behxhet Shala)

MOLLIQI Arif (1953-). Shkrimtar. Lindi në Llukë të Epërme të Deçanit. Shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në Deçan, studimet për gazetari në Universitetin e Prishtinës. Nga viti 1980 deri më 1991 ka punuar në shërbimet për çështje civile dhe përmbarime në Gjykatën Komunale në Deçan. Në vitin 1996 emigroi në Gjermani. Në fillim ka shkruar satirë, më vonë poezi, prozë, dramë etj. Ka bashkëpunuar me shumë gazeta e revista, sidomos me gazetën humoristike "Thumbi". Krijime të tij letrare janë shpërblyer ndër konkurse letrare, janë paraqitur në panorama e antologji dhe janë përkthyer në gjuhë të ndryshme. Ka botuar librat e poezisë: "Simfoni për darkën e qenve" (1994), "Në udhëkryq pa zhurmë" (1996), "Psherëtima e zareve" (1999), "Premiera e një pranvere" (2000), "Pelegrinazh i ftohtë në qytetin D." (2004), "Portret i pambaruar" (2006), "Një hije bënte rrugë" (2009), "E dashura ime Eva" (2013). Është autor i dramave "Loja e Sarkofagut" (1998), "Loja e dytë e Sarkofagut" (2004) dhe i romaneve "Kafka e ujkut" (2001), "Shënime nga arkiva e qytetit D." (2003), "Gruaja e vizatuar nudo" (2008), "Simfoni për darkën e qenit" (2012). Ka botuar librin publicistik "Përplasje - skica dhe mbresa" (2000) dhe monografitë "Dëshmorët jetojnë pas vdekjes" (2002) dhe "K. Sh. Verrat e Llukës - Hamburg" (2007). (Shaip Beqiri)

MONOPOLI. Gjendje kur në anën e ofertës ekziston vetëm një firmë, ndërsa kërkesa në shumicën e rasteve është joelastike. Fuqia monopoliste shfaqet kur në treg nuk ka konkurrencë, sepse ekzistojnë pengesa për hyrjen e firmave të tjera në atë fushë të prodhimit ose të shërbimeve. Në rrethana të këtilla monopolisti e cakton çmimin, i cili nuk është i përcaktuar më parë nga forcat e jashtme të tregut. Në Kosovë nuk ekziston një traditë aq e hershme e formimit të monopoleve, por, megjithatë, së fundi është vërejtur shfaqja e monopolit në fushën e prodhimit dhe të shpërndarjes së energjisë elektrike dhe në shërbimet e postës dhe të telekomunikacionit. Mund të gjendet edhe ndonjë sektor tjetër, ku

shfaqen tendenca monopoliste, siç është sektori i bankave. Ne përgjithësi elemente të sjelljes monopoliste një kompani shpreh atëherë kur kontrollon më shumë se 30% të tregut. Që të evitohet situata e monopolit në disa veprimtari, shteti ndërhyr me rregullatorët e çmimit real, duke përcaktuar edhe standardet e cilësisë së produkteve dhe të shërbimeve. Në Kosovë funksionojnë disa rregullatorë të këtillë, si në fushën e furnizimit me energji, me ujë etj., ku janë përcaktuar çmimet kundrejt standardeve të cilësisë. (Sinan Ademaj)

MONUMENTET E KULTIT BIZANTIN.

Janë objekte kulti të rritit bizantin ortodoks, të ndërtuar nga periudha paleokristiane e deri me rënien e Kosovës nën sundimin osman. Gjatë periudhës së Perandorisë Bizantine u bë një përparim i ndjeshëm në ndërtimin e monumenteve të kultit. Në shek. IV-V qendrat më të njohura të krishterimit të hershëm bizantin në provincën e Dardanisë konsideroheshin Nishi, Shkupi dhe Ulpiana. Vetëm në Shkup dhe rrethinë janë zbuluar afro 10 bazilika bizantine. Në Ulpianë, si qendër ipeshkvnore, është zbuluar një monument i kultit bizantin, ndërsa shumë kohë më parë është zbuluar bazilika e madhe, ku janë ruajtur reliktet e martirëve të Ulpianës, Flori dhe Lauri. Martirët dardanë nga Ulpiana u ngritën gjatë mesjetës në kultin e martirëve kishtarë bizantinë edhe te sllavët e ardhur, të cilët krishterimin e përqafuan nga mesi i shek. IX. Një shembull ku përmendet Flori dhe Lauri është menologu i Patrikanës së Pejës i vitit 1561.

Ndërkaq, periudha vijuese (shek. VI-IX) karakterizohet me ndërtime masive. Krahas ndërtimeve me karakter mbrojtës, periudha e Justinianit është dalluar edhe me ndërtime të bazilikave monumentale. Në shek. X vërehet në përgjithësi një rritje e nivelit të ndërtimeve. Ndërkaq, monumentet e kultit bizantin gjatë shekujve X-XV dallohen për shumëllojshmërinë e tipave arkitektonikë.

Në mesjetën e hershme territori i sotëm i Kosovës, i Maqedonisë dhe i Serbisë Jugore ishin nën ndikimin e kulturës bizantine. Monumentet më të njohura të grupeve stilistike bizantine (shek. IX-XIII) në Maqedoni janë të përqendruara në Ohër, i cili në këtë periudhë ishte qendra kryesore kulturore dhe fetare. Të tilla janë Kisha e Shën Naumit, Shën Klimentit

(Ohër), Kisha e Shën Pantelejmonit (Shkup), si dhe kompleksi i Manastirit të Studenicës (Istog). Bazilikës bizantine i takonin edhe dy varreza nëntokësore të murosura për shumë njerëz, si dhe qeramika bizantine e hershme.

Ndikimi bizantin i gërshetuar me artin e Adriatikut është i pranishëm në monumentet më të rëndësishme të kultit në Kosovë gjatë shek. XIII-XIV, siç janë: Manastiri i Deçanit, kompleksi i Patriarkanës së Pejës, Kisha e Zojës së Bekuar në Prizren, Manastiri i Banjskës (Mitrovicë), Kisha e Shën Mitrit në Mitrovicë etj. Edhe rindërtimi i Manastirit të Graçanicës është bërë tërësisht nën ndikimin e arteve bizantine, për nder të Simonidës (1294-1340), vajzës së perandorit bizantin Androniku II Paleolog. (Hamdi Mediu)

MONUMENTET E LASHTA SLLAVE-MESJETARE (Vetera monumenta Slavorum Meridionalium Historiam). Përmbledhje dokumentesh mesjetare në gjuhën latine dhe italiane nga arkivat e Vatikanit, që hedhin dritë mbi historinë e trojeve shqiptare dhe të gjendjes kishtare në këto vende, veçanërisht për Kosovën dhe Zetën nga fundi i shek. XII deri në fund të shek. XVIII. Janë dokumente papale, duke filluar nga papa Inoçenti III, Benedikt XI, Gjonit XXII, Piut II e deri te ata të shek. XVIII. Letrat e disa prelatëve katolikë (më 1204) drejtuar papës Inoçentit III dhe përmendja e emrave të ipeshkvijve katolikë: Marinit të Kishës së Shkupit; ipeshkvit katolik të Prizrenit, Abrahamit; ipeshkvit katolik të Nishit, Kirikuit etj; kishat katolike në Prizren më 1346 (*Sancta Maria de Prisren et Sanctus Petrus supra Prisren*); Kisha Katolike e Shën Nikollës dhe e Shën Mërisë në Novobërdë më 1458; mbi juridiksionin dhe lidhjet e Kishës së Zetës me Papatin në shek. XII; Koncili i Tivarit i vitit 1199; akti i kalimit të Balshajve në vitin 1369 nga riti ortodoks në atë katolik; vendosja në Durrës dhe Arbëri e françeskanëve dhe dominikanëve; përndjekjet e katolikëve nga Stefan Uroshit II. Pastaj: dokumente për Shkodrën, Tivarin, Ulqinin, Prishtinën etj., gjatë luftërave turko-venedikase në vitet 1538-1574; ekspeditat turke kundër malësorëve më 1610; disa relacione të Nikollë Mekajshit drejtuar papës Palit V në korrik të vitit 1610 mbi projektin e organizimit të kryengritjes në Arbëri; relacioni i argjipeshkvit të Shkupit, Pjetër Bogdanit mbi gjendjen kishtare në Arbëri; njoftime

gjeografike-historike për Argjipeshkvinë e Tivarit, Ipeshkvinë e Shkodrës, Ulqinit, Pultit, Prizrenit, Drishtit, Sardës, Kotorrit etj.; të dhëna për Kosovën, banorët dhe qytete e saj: Kratovën, Prizrenin, Novobërdën, Prishtinën, Vushtrrinë, Mitrovicën etj. Dokumentet janë përmbledhur nga njohësi i mirë i lëndës së proveniencës së Vatikanit, Augustino Theiner, i cili në vitet 1863 dhe 1875 i botoi në dy vëllime: “*Vetera Monumenta Slavorum Meridionalium Historiam Illustrantia*”, vëllimi I (1198-1549) dhe vëllimi II (1524-1800), Romë, Zagreb 1863, 1875. (Gjon Berisha)

MONUMENTET E SHKATËRRUARA NGA LUFTA (1998/99). Gjatë luftës së viteve 1998/99 në Kosovë forcat ushtarake, policore dhe paramilitare serbe plaçkitën, dogjën, gra-



XHAMIA E HADUMIT NË GJAKOVË, NJËRI NGA MONUMENTET E SHKATËRRUARA GJATË LUFTËS

natuan dhe shkatërruan një pjesë të madhe të trashëgimisë kulturore në Kosovë. Monumentet e shkatërruara i takojnë shek XV-XIX. Shkatërrime u bënë edhe para këtyre viteve, kryesisht gjatë realizimit të planeve urbanistike dhe të planifikimeve hapësinore nëpër qytetet e Kosovës. Këto plane urbanistike kishin synim parësor zhdukjen e komplekseve urbane-arkitekturnale, të ekzemplarëve të veçantë të objekteve të vjetra qytetare publike dhe të banimit, që kishin vlera historike, artistike, arkitekturnale, mjedisore etj. Për një kohë të gjatë u gjendën në shënjestër veçmas lokalitetet arkeologjike, komplekset historike dhe çdo gjë tjetër që dëshmonte autoktoninë e shqiptarëve në Kosovë. Por në luftën e fundit këto shkatërrime morën përmasat e gjenocidit kulturor. Në vitin 1998 u bombardua, u plaçkit dhe u dogj kompleksi i kullave të vjetra në Deçan.

Rrënimet e vitit 1998 u pasuan nga shkatërrimet shfarosëse, që filluan në mars dhe vazhduan deri më 12 qershor të vitit 1999, kur u plaçkitën, u dogjën dhe u rrënuan në tërësi një numër i madh i trashëgimisë etnokulturore e historike shqiptare, si: kompleksi i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit; kompleksi i Lidhjes Shqiptare në Pejë; komplekset e çarshive të vjetra në Pejë, Gjakovë dhe Vushtrri; pastaj xhamitë klasike monumentale, hamamet, teqetë, medresetë etj. Fat të njëjtë patën edhe komplekset ruralo-arkitekturale të kullave në Nivokaz, Junik, Batushë, Prilep, Strellc, Raushiq, Vranoc, Vrellë, Istog, Dobroshec, si dhe shumë kulla në fshatra të tjera, që i përkëtinin shek. XVIII-XIX. Edhe konakët me kulla qytetare të Pejës pësuan rrënimet të rënda. Nga monumentet mbetën vetëm muret bartëse, që konstruktivisht nuk janë më të qëndrueshme. Bashkë me monumentet u dogjën edhe pjesët dekorative-funksionale, si tavanet, musandrat, dollapët, raftet, dyert si dhe lëndët e tjera etnologjike, armët e vjetra, jastëkët, enët e ndryshme, veshjet tradicionale kombëtare të meshkujve dhe të femrave etj. Përveç djegieve dhe rrënimëve, administrata e dhunshme serbe plaçkiti edhe tërë dokumentacionin dhe dosjet nga arkivi i Entit Krahinor për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës në Prishtinë. Në vitin 1998 nga Muzeu i Kosovës që punonte nën masat e administrimit serb u zhvendosën në Beograd për një ekspozitë dhe më pas nuk u kthyen më 643 ekspozite arkeologjike dhe 571 ekspozite etnologjike. Nga ekspozitat arkeologjike nuk janë kthyer 110 objekte nga periudha e neolitit dhe eneolitit, 271 objekte nga koha e bronzit dhe e hekurit, 133 objekte nga periudha antike, 98 objekte nga periudha mesjetare, si dhe 31 monedha nga periudha romake. Përveç kësaj, sipas regjistrimit të ekspoziteve të bërë në vitin 1990, në Muzeun e Kosovës janë evidentuar 7,290 ekspozite, ndërsa pas përfundimit të luftës, gjatë muajit qershor 1999, janë bartur 13 arka me material etnologjik nga Muzeu i Kosovës në Muzeun Etnologjik të Beogradit. Regjistrimi i materialit etnologjik, i bërë në vitin 2000, nxjerr edhe mungesën e 2,480 ekspoziteve të tjera. (Fejz Drançolli)

MONUMENTET RAGUZANE (Monumenta Ragusina). Dokumente që përfshijnë vendimet e këshillave të Raguzës (Këshillit të Madh, të Vogël dhe të Rogatëve), si dhe dokumenteve të

kancelarisë, noterisë, letrat e korrespondencave etj. Duke i konsideruar për burime themelore, vendimet e këshillave raguzane ndërliidhen edhe me regjistra të tjera arkivorë, siç janë: *Liber vendicionum* (viti 1395), *register commissionum* (1396), *liber lamentationum de foris* (1397), *Liber Viridis* (Libri i Gjelbër) dhe *Liber Croceus* (Libri i Verdhë). Së pari vendimet e këshillave janë botuar në një regjistër të veçantë të radhitur sipas vëllimeve (*Refermationes*), të cilat datojnë nga kapërcyelli i shek. XIII, por si të tilla janë ruajtur vetëm vendimet, që datojnë nga viti 1301. Vendimet e këshillave raguzane nga viti 1415 janë botuar në regjistra të veçantë: *Cansilium Maius* (Këshilli i Madh), *Cansilium Minus* (Këshilli i Vogël) dhe *Cansilium Rogatorum* (Këshilli i Rogatëve). Botimi i këtyre burimeve është i njohur prej kohësh, por në mënyrë sistematike janë edituar së pari nga arkivisti dhe studiuesi Giuseppe Gelcich-i (*Monumenta Ragusina. Libri reformationum*), gjatë gjysmës së dytë të shek. XIX, pastaj nga medievalistë të ndryshëm kroatë dhe serbë deri në vitet e fundit. Pushteti dhe fuqia e Raguzës dhe e bujarisë së saj ishte e pranishme edhe në prapatokën ballkanike. Së këndejmi, janë ruajtur njoftime të shumta edhe për qytetet e Kosovës dhe për marrëdhëniet e Raguzës me zotëruesit e Kosovës, si: Balshajt, Brankoviçët, Dukagjinët, Kastriotët, Lazareviçët etj. (Jahja Drançolli)

MONUMENTET SERBE (Monumenta Serbica). Burime të shkruara mesjetare serbe, të ruajtur në vendburime të ndryshme europiane dhe më gjerë. Këto burime janë hulumtuar dhe botuar nga medievalisti dhe filologu sloven, Franc Mikloshiç (Franz Miklosich) i shek. XIX (Vjenë 1858; Grac, 1964; botim fototip). Mikloshiçi, duke vepruar në Vjenë, ka pasur mundësi të shfrytëzojë lëndën cirilike të Republikës së Raguzës, e cila ishte bartur pas vitit 1815 në Vjenë. Përveç cirilikës raguzane, në përmbledhjen e tij Mikloshiçi ka shfrytëzuar në mënyrë të përzgjedhur lëndën burimore të botuar më parë nga Pavle Karanotvërtkoviç. Gjithashtu Mikloshiçi ka vjelë për botim edhe lëndën nga vëllimet e autorëve, si Farlati ("Illyricum Sacrum"), D. Avramoviç, V. Karaxhiqi, J. Rajiqi, P. J. Shafariku etj. Përveç lëndës burimore raguzane, botimi përfshin edhe lëndë burimore nga Manastiri i Hilandarit dhe nga ndonjë tjetër burim që ruhet në malin

Atos (Greqi). Të gjitha burimet, përkatësisht kartat cirilike përmbajnë njoftime elementare, siç janë: vula, nënshkrimi në vulë, adresa, shënimet në pjesën e pasme të dokumentit, vendi ku është zbuluar botimi i tij (nëse është botuar ndonjëherë më parë) etj. Duke marrë parasysh metodën kritike të aplikuar dhe kohën kur janë botuar, kjo përmbledhje shfrytëzohet edhe sot nga historianët, filologët dhe studiuesit e fushave të tjera shkencore. (Muhamet Mala)

MONUNI. Mbret i Dardanisë, i cili sundoi pas mbretit Bato. (shek. II). Nën sundimin e tij Dardania vazhdoi armiqësinë me maqedonët, të cilët ishin marrë vesh me parë me bastarnët, fis thrakas, që t'i shfarosnin dardanët. Plani nisi të realizohej në vitin 176 p.e.r., pas vdekjes së Filipit V, por Monuni mobilizoi të gjitha forcat ushtarake dardane dhe pas një lufte shumë të ashpër i dëboi bastarnët. Monuni lidhi aleancë me ilirët e tjerë për t'i kundërshtuar romakët, aleatë të mëparshëm. Si përforcim të aleancës e fejoj fillimisht të bijën Etutën me mbretin e shteti ilir Platorin dhe pastaj e martoi me Gentin, mbretin e të njëjtit shtet. Vendosi marrëdhënie të mira me etolët dhe u dërgoi mercenarë në luftë kundër romakëve. (Emine Kalaja-Hajdari)

MORAÇIQ (Moračić) Velibor (1919-2010). Mjek, kirurg, profesor universiteti. Lindi në Prishtinë, shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në vendlindje, ndërsa Fakultetin e Mjekësisë në Beograd (1952). Punoi në repartin e kirurgjisë të Spitalit të Përgjithshëm të Prishtinës. Specializimin nga kirurgjia e përgjithshme e kreu në Fakultetin e Mjekësisë në Shkup dhe më 1969 fitoi titullin primarius. Mbrojti temën e doktoratës më 1977 në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë dhe më pas u zgjodh docent, pastaj profesor inordinar dhe më 1981 profesor ordinar i kirurgjisë së përgjithshme dhe luftarake në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës. Për aftësim profesional nga lëmi i kirurgjisë abdominale qëndroi në Klinikën e Kirurgjisë të Universitetit "La Sapienza" të Romës. Ishte drejtor i Klinikës së Kirurgjisë dhe i Ortopedisë në periudhën 1973-1987. Dha kontribut të rëndësishëm në edukimin e kirurgëve të rinj dhe në zhvillimin e kirurgjisë në përgjithësi në Kosovë. Është autor dhe bashkautor i shumë punimeve shkencore

dhe profesionale. Pas pensionimit është angazhuar në aktivitete humanitare, kryesisht në Mitrovicën e Veriut dhe në enklavat serbe në Kosovë. (Avdyl Krasniqi)

MORAVA E BINÇËS. Lumë në fushën e Anamoravës, në juglindje të Kosovës. Formohet me bashkimin e Rekës së Madhe dhe lumit të Sllatinës, në afërsi të fshatit Binçë, prej nga e ka marrë emrin. Përmes Moravës së Binçës, ujërat e Anamoravës derdhen në Detin e Zi. Sipërfaqja ujëmbledhëse është 1,715 km², nga e cila në territorin e Kosovës ndodhen 1,560 km² ose 89.1%. Ka gjatësinë rreth 60 km. Shtratin e ka të cekët, me brigje të gërryera dhe me lëkundje të shumta në prurjet e ujit. Prurjet mesatare vjetore janë rreth 10.47 m³/s. Maksimumi i prurjeve është në muajin mars, me 27 m³/s, ndërsa minimumi gjatë muajve gusht dhe shtator, me 1.7 m³/s. Nga ana e djathtë i bashkohen disa degë që kullojnë shpatet veriore të Karadakut: lumi i Binçës, i Zhitisë, i Letnicës dhe i Zhegrës. Nga ana e majtë merr lumin e Livoçit, të Gjilanit dhe të Krivarekës, e cila përbën degën e tij kryesore. Morava e Binçës, pasi kalon grykën e Gjilanit (15 km) dhe grykën e Konçulit (14 km), rrjedh nëpër fushën e Bujanocit. Në afërsi të Bujanocit bashkohet me Moravicën e Preshevës dhe formon Moravën Jugore. Për këtë arsye, në aspektin hidrografik, konsiderohet si degë burimore e Moravës Jugore. Mungesa e reshjeve dhe prurjet e luhatshme të ujit të Moravës së Binçës dhe degëve të saj e kanë bërë të nevojshme ngritjen e akumulimeve ujore. Një i tillë është ngritur në lumin e Livoçit dhe të Përlepticës, të cilët shfrytëzohen për ujitjen e tokës punuese, për pije, rekreacion dhe peshkim. (Arsim Ejupi)

MORAVICA E PRESHEVËS. Lumë në Luginën e Preshevës. Me këtë emër quhet prej stacionit hekurudhor të Preshevës, ku bashkohen lumi i Norçës me lumin e Preshevës. Është lumë tipik fushor, me rënie rreth 1.15 m/km. Për këtë arsye është shpesh i shpërndarë (difuz), kurse në disa vende është vështirë t'i përcaktohet rrjedhja. Nga ana e majtë i bashkëngjiten lumi i Kurbalisë, i Rahovicës, i Raincës, kurse nga ana e djathtë lumi i Leranit dhe i Bushtranit. Dallohet me një regjim shumë të pavolitshëm hidrologjik. Gjatë stinës së verës shumica e degëve shterojnë, ndërsa Moravica zvogëlon

dukshëm prurjet e ujit. Mungesa e sistemit efikas për menaxhimin e mbeturinave dhe kanalizimeve e ka shndërruar atë në një kolektor të hapur të ujërave të ndotura dhe mbeturinave. Nivelet e larta të ndotjes kanë sjellë deri të zhdukja e botës bimore dhe shtazore në këtë lumë. (Arsim Ejupi)

MORINA Adnan (1935-1999). Gjeograf, pedagog. Lindi në Prizren, shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në vendlindje, studimet universitare në Universitetin e Shkupit (1961), studimet pasuniversitare në drejtimin e gjeografisë së popullsisë dhe të vendbanimeve në Beograd (1973), ku mbaroi edhe studimet e doktoratës (1978). Një kohë punoi mësimdhënësi i gjeografisë në gjimnazin e Prizrenit, më pas në Akademinë Pedagogjike dhe në Entin Pedagogjik të Prizrenit. U mor edhe me kërkime shkencore nga lëmi i gjeografisë dhe publikoi një numër punimesh shkencore dhe profesionale, përfshirë edhe tezën e doktoratës, që u botua si libër i veçantë (“Podrimja: studim socio-gjeografik”, 1985). Me kumtesa shkencore mori pjesë në seminare, simpoziume dhe kongrese brenda dhe jashtë vendit. Për punën e tij pedagogjike dhe shkencore u nderua me çmime dhe mirënjohje. Ishte anëtar shumëvjeçar i shoqërisë kulturore-artistike “Agimi” në Prizren. (Bashkim Kabashi)

MORINA Adrian (1981-). Aktor, producent. Lindi në Prizren. Shkollimin fillor dhe të mesëm i kreu në vendlindje, ndërsa studimet për aktrim në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. Që nga viti 2000 ka luajtur në një sërë shfaqjesh teatrore në Kosovë dhe Maqedoni dhe ka xhiruar një sërë filmash dhe produksionesh televizive. U paraqit në rolet kryesore në shfaqjet “Tre gjermanët e trashë”, Roberto Zuko”, “Per Gynti”, “Nata e dymbëdhjetë”, “Armiku i popullit”, “Shembja e kullës së Ajfelit” etj., si dhe në serinë televizive “Tre gjermanët e trashë” (2005-2007). Me shfaqje është prezantuar në turne dhe festivale të teatrit brenda dhe jashtë vendit. Në vitin 2010 e hapi kompaninë për prodhimin e filmave dhe produksioneve televizive “Orion Production”, me të cilën realizoi seriale dhe emisione televizive në Radiotelevizionin e Kosovës dhe në “Kohavision”. (Visar Krusha)

MORINA Arbnor (1964-). Futbollist, trajner. Lindi në Prishtinë, edhe karrierën e nisi që

në moshë të re te skuadra e “Prishtinës”, duke kaluar nëpër të gjitha gjeneratat e këtij klubi. Në edicionin 1983/84 firmosi kontratën e parë profesionale me këtë ekip. Ishte kapiteni i fundit i “Prishtinës” në Ligën e ish-Jugosllavisë dhe i pari në Ligën e Kosovës. Në vitet 1991-1994 bëri karrierë në ligën profesionale të Zvicrës, me skuadrën “FC Etoile-Carouge”. Më pas luajti në Maqedoni te “Tikveshi” i Kavardarcit dhe “Slloga Jugomagnat” e Shkupit. Në ligën maqedonase u zgjodh lojtari më i mirë i huaj dhe qendërmbrojtësi më i mirë i vitit. Në vitin 1996 u kthye te “Prishtina” dhe po atë vit u shpall futbollisti më i mirë i vitit në ligë. Ishte edhe futbollist i përfaqësueses së Kosovës dhe kapiteni i saj. Prej vitit 1997 nisi karrierën e trajnerit. Drejtoi ekipet U-21 të Kosovës, pastaj “Prishtinën”, “Hysin”, “Dritën”, “Besën” etj. (Tahir Sopi)

MORINA Armond (1973-). Aktor, producent. Lindi në Gjakovë. Në vitin 1996 kreu studimet për aktrim në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. Nga periudhën 2001-2007 ishte asistent i lëndës së aktrimit te prof. Faruk Begolli. Nga viti 2005 themeloi kompaninë filmike “Morina Films” dhe punoi si producent kryesisht në filma të shkurtër dhe dokumentarë. Gjatë viteve ’90 luajti një sërë rolesh



ARMOND MORINA

në shfaqjet teatrore të inskenuara në Teatrin “Dodona”, në Teatrin Kombëtar në Prishtinë dhe në Teatrin e Gjakovës. Në televizion u paraqit në njërin nga rolet protagonist në serialin e njohur televiziv prej 300 episodësh “Familja moderne”. Interpretoi role në dy projekte filmike: “Kukumi” në regji të I. Qosjes, prodhim i “Kosovafilmit” dhe “Lufta ka mbaruar” në regji të M. Panovit, i prodhuar në Maqedoni. Në vitin 1999, me shfaqjen “Hamleti”, realizuar nga D. Gothard, si aktor-ambasador u paraqit në një konferencë në Afrikën Jugore. (Jeton Budima)

MORINA A. Arsim (1956-). Mjek, neurokirurg, profesor universiteti, anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (ASHAK). Lindi në Pejë, aty mori shkollimin bazë, kurse studimet i kreu



ARSIM MORINA

në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë (1980). Specializimin për neurokirurgji e kreu në Lubjanë, Slloveni (1986), ndërsa studimet pasuniversitare i kreu në Fakultetin e Mjekësisë në Zagreb. Mbrojti tezën e doktoratës në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Tiranës (1996). Në vitin 1990 u larguan me dhunë nga puna bashkë me kolegët e tjerë dhe vazhdoi të punojë në ordinancën e tij private në Pejë (1990-1999). Ishte mjek mysafir në disa Qendra Klinike të jashtme, si në Klinikën e Neurokirurgjisë në Lubjanë, në Spitalin St. Anna në Lucern të Zvicrës, në Klinika Neurokirurgjike në Duisburg të Gjermanisë etj. Në vitin 1999 u kthye në Klinikën e Kirurgjisë të Qendrës Klinike Universitare në Prishtinë. Më 2001 ishte në subspecializim në Klinikën e Neurokirurgjisë në Dusseldorf të Gjermanisë. Mori pjesë në dy trajnime aktive për shkathësi kirurgjikale dhe trajnim të trajnerëve të organizuara nga Kolegji Mbretëror i Anglisë (2004). Është profesor i rregullt i kirurgjisë dhe kirurgjisë luftarake në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës. Në vitin 2012 u zgjodh anëtar korrespondent i ASHAK-ut. Ka marrë pjesë në shumë konferenca shkencore dhe profesionale brenda dhe jashtë vendit. Ka publikuar një numër punimesh shkencore dhe profesionale. Është bashkautor i tekstit universitar “Neurotrauma”. (Avdyl Krasniqi)

MORINA Bajrush (1962-). Gazetar. Lindi në fshatin Gexhë të komunës së Rahovecit. Shkollimin fillor e kreu në vendlindje, të mesmen në Rahovec dhe Fakultetin e Filologjisë, degën gjuhë dhe letërsi shqipe në Universitetin e Prishtinës. Me gazetari filloi të merret nga viti 1988. Në fillim punoi në revistën “Zëri i rinisë”, më pas kryeredaktor i gazetës së studentëve “Bota e re” dhe sërish në revistën “Zëri”, ku punoi deri më 1997. Po atë vit, me një grup gazetarësh themeloi gazetën javore “Gazeta shqiptare”, e cila u botua deri në mars të vitit 1999. Pas luftës punoi redaktor në gazetën e përditshme “Bota sot”, duke u bërë kryeredaktor i saj deri në dhjetor të vitit 2013. Në shkurt të vitit 2014 themeloi gazetën e përditshme dhe portalin “Bota press”. Ka

botuar librat publicistikë: “Me dy burra të Kosovës, Ibrahim Rugova e Mark Krasniqi” (2012), “Tribunali i Hagës, qelia ime numër 26” (2012) etj. (Veli Bytyçi)

MORINA Faik (1958-). Piktore. Lindi në Pejë. Kreu shkollimin fillor dhe të mesëm në vendlindje, ndërsa studimet për pikturë në Akademinë e Arteve të Universitetit të Prishtinës (1983). Po atë vit u vendos në Zvicër, ku jeton dhe sot dhe punon si mësime në Fribourg. Ka hapur disa ekspozita personale: në Shtëpinë e Kulturës në Pejë (1979), pastaj në Zvicër, në Galerie d’Art et d’Antiquite (1984), në La Bohème, Nojshatel (1984), në Galeria REX, Fribourg (1985), 4 herë me radhë në Bulle Musee Gruieren (1985-2001), në Galerie Les Particules (2015) etj. Mori pjesë në ekspozitat kolektive të organizuara nga Shoqata e Artistëve Figurativë të Kosovës në Pejë (1980), Beograd (1983), Sarajevë (1983), Prishtinë (1983) si dhe në Payerne, Avenches, Montreux, Fribourg, Romainmotier, Givisiez (Zvicër) etj. Shquhet për nga fryma ekspresive e peizazheve dhe e figuracionit. Cikli i fundit i krijimtarisë së tij “Loja e rrezikshme” shpërfaq mllëfin kundër klonimit apo eksperimenteve ndaj natyrës. Jeton dhe krijon në Zvicër. (Ilir Muharremi)

MORINA Ferid (1954-). Piktore. Lindi në Pejë. Kreu Shkollën e Mesme të Artit në Pejë, ndërsa Akademinë e Arteve në Prishtinë (1975). Është autor vizatimesh dhe pikturash. Hapi katër ekspozita personale dhe ishte pjesëmarrës në disa ekspozita kolektive. Hapi ekspozita personale në Milano (1990) dhe në Manjago në Itali (1990), pastaj në Arnhem të Holandës (2000) dhe në Galerinë e Ministrisë së Kulturës në Prishtinë (2006). Është i njohur me përdorimin e formave gjeometrike dhe dritëhijes. Trajton tema nga arkitektura e mjedisit ku jeton. Në koloninë artistike në Plavë, Mal të Zi (2008), mori çmimin e parë. U shpërblye edhe në një koloni artistike në Itali (2012). (Ilir Muharremi)

MORINA Haki (1963-). Publicist, poet. Lindi në Gllarevë të Klinës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, të mesmen e nisi në Kijevë, por u përjashtua për shkak të veprimtarisë politike. U dënua 7 vjet burg, të cilat i vuajti në burgje të ndryshme të ish-Jugosllavisë. Pas daljes nga burgju (1991), për shkak të ndjekjes

së vazhdueshme, u detyrua të arratisë në Shqipëri. Në Tiranë studioi shkencat politike, më pas u zhvendos në Zvicër, ku vazhdoi aktivitetin politik. Për 8 vjet ishte anëtar i redaksisë së gazetës “Zëri i Kosovës”. Botoi disa libra me poezi “Bashkë me jetën” (2012), “Për dëshmorët dhe për dashurinë” (2014) dhe “Pak Shqipëri dhe pak dashuri” (2015) etj. Botoi edhe librin publicistik “Mendime politike” (2011). Jeton në Zvicër. (Ibrahim Berisha)

MORINA Idriz (1973-). Gazetar. Lindi në Hodonoc të Kamenicës. Shkollën fillor dhe të mesmen i kreu në vendlindje dhe Kamenicë, studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin Filologjik të Prishtinës. Nga viti 1999 punoi gazetar në të përditshmen “Bota sot”, ndërsa nga viti 2004 në gazetën “Kosova sot” dhe “Pavarësia”. Punoi edhe në disa agjenci lajmesh, si gazetar dhe redaktor. Nga viti 2012 ishte kryeredaktor për botimin e diasporës në gazetën e përditshme “Bota sot” dhe nga viti 2013 edhe në botimin për Kosovë. (Shefqet Rexhepi)

MORINA Kadri (Raif) (1955). Inxhinier i ndërtimitarisë, profesor universiteti. Lindi në fshatin Hodonoc të Kamenicës, shkollimin fillor e kreu në vendlindje, ndërsa në Gjilan kreu shkollën e mesme teknike. Studioi për ndërtimtarinë në Fakultetin Teknik të Universitetit të Prishtinës (UP) (1979). Kreu studimet pasuniversitare në Universitetin e Zagrebit, ndërsa tezën e doktoratës e mbrojti në Universitetin e Shkupit (2014). Në fillim punoi në Kamenicë dhe më pas në Gjilan. Më 1980 u zgjodh asistent në Fakultetin e Ndërtimitarisë dhe të Arkitekturës të UP-së dhe më pas ligjërues për lëndën konstruksionet e betonit. Është autor i disa dispensave për studentë për lëndët e konstruksioneve të betonit dhe i tekstit universitar “Detyra të zgjedhura nga betoni i paranderë”. Mori pjesë në kongrese shkencore, simpoziume dhe konferenca të inxhinierisë së ndërtimit në vend dhe jashtë. Punoi edhe në fushën e projektimit, të mbikëqyrjes së projekteve për objekte shkollore, halla industriale, komplekse banesore dhe palestra sportive. (Misin Misini).

MORINA Lulëzim (1972-2000). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Lindi në fshatin Hallaq i Vogël të Lipjanit. Në vitin 1990 emigroi në Kroaci (1990), ku iu bashkua

vullnetarisht ushtrisë kroate. Mori pjesë edhe në luftën e Bosnjës. Më 1996 emigroi në Gjermani. Në maj të vitit 1998 u kthye Kosovë, ku u sistemua në Zonën Operative të Dukagjinit. Ishte anëtar i Shtabit të Zonës Operative dhe zëvendëskomandant i Brigadës 132 “Myrtë Zeneli”. Mori pjesë në shumë beteja kundër ushtrisë dhe policisë serbe, si në Gllogjan, Gërgoc etj. Për katër muaj (qershor-shtator 1998) ishte komandant i vijës së frontit në Prilep. Në mars të vitit 1999 u emërua komandant i Brigadës 135 “Agim Zeneli”, detyrë që e kreu deri në çlirimin e vendit. Pas luftës u angazhua në Trupat Mbrojtëse të Kosovës. Humbi jetën në një aksident trafiku në vitin 2000. (Hajrush Kurtaj dhe Mustafë Haziri)

MORINA Qemajl (1951-). Teolog islam, mësimdhënëse, publicist. Lindi në fshatin Hodonoc të Kamenicës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, të mesmen në Medresenë “Alaudin” në Prishtinë, studimet në Fakultetin e Filologjisë në Universitetin “Umduruman” në Sudan (1976), ndërkaq studimet pasuniversitare i mbaroi në Universitetin e Kajros (1979). Pas studimeve punoi në Bengazi të Libisë (1980-



QEMAJL MORINA

1989), në detyrën e sekretarit dhe të përkthyesit në Ministrinë e Shëndetësisë të Libisë. Më 1990 u punësua në kryesinë e Bashkësisë Islame të Kosovës si bashkëpunëtor profesional për shtyp dhe po atë vit u emërua kryeredaktor i revistës “Dituria islame”, ndërkaq nga viti 2001 ushtroi detyrën e kryeredaktorit të revistës “Edukata islame”. Ligjëroi gjuhën arabe në katedrën e orientalistikës të Fakultetit të Filologjisë (1990-1992), ndërsa që nga hapja e Fakultetit të Studimeve Islame në Prishtinë (1992) ligjëroi gjuhën arabe. Ka bërë hulumtime në Londër, në Institutin për Studime Orientale (1978), në Arkivin Qendror të Egjiptit në Kajro (1976-1977) dhe në Arkivin Kombëtar të Libisë, dega në Bengazi (1980-1982). Ishte përfaqësues i Bashkësisë Islame të Kosovës në dosjen e dialogut ndërfaqësor “Islami dhe krishterimi” gjatë viteve 1998-2013. Është autor i një sërë shkrimesh të botuara në revista të ndryshme shkencore, letrare dhe informative brenda dhe jashtë

vendit. Botoi monografitë “Hoxhë Kadri Prishtina - mendimtar islam” (2000), “Lidhja Shqiptare e Prizrenit në shtypin egjiptian (1878-1881)” (2007), “Glosari i nocioneve fetare (islame, ortodokse, katolike dhe çifute)” (2010) etj. (Ramadan Shkodra)

MORINA Rrahman (1943-1990). Politikan. Lindi në Loxhë të Pejës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, të mesmen në Pejë, Fakultetin Ekonomik në Prishtinë. Një kohë punoi si punonjës policie në organet e punëve të brendshme të Kosovës. Pas demonstratave të vitit 1981 u emërua sekretar krahnor i Punëve të Brendshme, detyrë të cilën e kreu deri në vitin 1988. Po atë vit u zgjodh kryetar i Komitetit Krahnor të LK të Kosovës. U bë i njohur për qëndrimin bashkëpunues me S. Millosheviqin, duke u përfshirë në grupin e funksionarëve politikë të Kosovës, që i shërbyen politikës antishqiptare që udhëhiqnin institucionet partiake e shtetërore të Serbisë në këtë periudhë. Më 1989, pas grevës së minatorëve të Trepçës dha dorëheqje, por pas ndërprerjes së grevës së minatorëve u rikthye në postin e mëparshëm. Vdiq në sallën e Kuvendit të Kosovës në Prishtinë, derisa po mbahej Kuvendi Themelues i Partisë Socialiste të Serbisë - dega për Kosovë. U varros në “Varrezat e të merituarve” në Beograd. (Fehmi Rexhepi)

MORINA Sadri (1959-). Gazetar. Lindi në Gllarevë të Klinës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, shkollën ekonomike në Pejë, ndërsa studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Një kohë punoi mësëmdhënës në Klinë, ndërsa nga vitit 1979 ishte gazetar në Televizionin e Prishtinës, në programin dokumentar-fejtonistik, ku realizoi një numër emisionesh nga terreni. Një kohë ishte korrespondent i disa medieve për Rrafshin e Dukagjinit. Është autor fejtoneesh dhe emisionesh të shumta dokumentare. Jeton në Klinë. (Shaqir Foniqi)

MORINA Sali (1891-1978). Mësues atdhetar. Lindi në Gjakovë, ku e mori edhe arsimin fillor. Kreu Normalen e Elbasanit. Ishte njëri nga themeluesit e shkollës shqipe në Gjakovë (1915) dhe drejtori i parë i saj. Më 1918 kaloi në Malësinë e Gjakovës, si bashkëluftëtar me Bajram Currin. Në vitin 1923 punoi si mësues

në Golaj (Has). Pastaj në internatin “Kosova” në Kolgecaj, ku ushtroi edhe detyrën e drejtorit të tij, më pas edhe të drejtorit të internatit “Kastrioti” në Peshkopi, mësues në Delvinë etj. Punoi me përkushtim si mësues dhe veprimtar i arsimit kombëtar. (Jusuf Meqa)

MORINA Visar (1979-). Regjisor. Lindi në Prishtinë. Shkollën fillore e kreu në Çikatovë të Vjetër (Drenas), ndërkaq të mesmen në Sindelfingen (Gjermani). Më 1994 emigroi



VISAR MORINA

në Gjermani. Kreu studimet për regji filmi në Akademinë e Arteve Mediale (KHM) në Këln (Gjermani). Bëri skenarin dhe regjinë e shtatë filmave të shkurtër, nga të cilët veçohet filmi “Der Schübling” (“Vdekja nga gulfatja”, 2009), me të cilin gjatë vitit 2010 fitoi disa çmime: filmi më i mirë në Fresh Film Fest International në Pragë, “Filmi ndërkombëtar më befasues i vitit” në Odense International Film Festival (Danimarkë), çmimi special i jurisë në Rencontres Henri Langlois à Poitiers në Paris, filmi më i mirë i shkurtër në Festivalin Ndërkombëtar të Filmit në Tiranë etj. Bëri edhe regjinë e filmit të shkurtër “Mbi qentë dhe tapetat” (ZDF/ARTE, 2010), i cili më 2013 u dha premierë në Festivalin e Filmit në Locarno (Zvicër). Në vitin 2014 ky film u nominua si filmi më i mirë gjerman nga Ministria e Kulturës e Gjermanisë. Suksesin më të madh e arriti me filmin e metrazhit të gjatë “Baba!” (2015), me të cilin u nderua me disa çmime: për regjinë dhe skenarin më të mirë në Filmfest Munih (Gjermani), për regjianë më të mirë në Europa Cinema Label 7 në Karlovy Vary International Film Festival (Çeki), Prix Cineuropa në Festival Cinema Méditerranéen në Bruksel, filmi më i mirë në Festivalin Ndërkombëtar të Filmit në Tiranë, si dhe disa çmime të tjera për aktorët e këtij filmi. Jeton dhe punon në Gjermani. (Doruntina Basha)

MORINA Yli (1972-1999). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), dëshmor. Lindi në Gjakovë. Gjatë viteve '90 emigroi në Holandë. Pas një kohe u kthye në Kosovë, për t'iu bashkuar luftës për liri. U emërua përgjegjës i njësitit komando të Zonës

Operative të Dukagjinit. Mori pjesë në betejat e zhvilluara në Baballoç, Prilep, Rastavicë, Carrabreg, Voksh, Junik, Hereç, Gramaçel, Dujakë, Shaptej etj. Më 10 gusht 1998, me njësitin e vet për më se dymbëdhjetë orë e ndali depërtimin e forcave serbe në Hereç, për të kaluar më vonë në frontin e luftës në Gramaçel, ku u plagos rëndë. Pas plagosjes u dërgua në spitalin ushtarak në Irzniq, pastaj në Kryshec. Në shtator të vitit 1998 u zu rob nga forcat serbe në fshatin Isniq, por me ndërhyrjen e Kryqit të Kuq Ndërkombëtar u dërgua në spitalin e Prishtinës dhe më pas në spitalin e Novi-Sadit. Nuk i përballoi operacionet e njëpasnjëshme dhe vdiq më 15 mars 1999. U varros me nderime në varrezat e qytetit të Gjakovës. (Manushe Ramosaj)

MORTI. Vdekja e anëtarit të familjes shkakton dhembje e pikëllim jo vetëm brenda familjes e vëllazërisë së të vdekurit, por edhe në fis dhe më gjerë. Si e këtillë, ajo bëhet objekt trajtimi i shumë vajtove dhe gjëmëtarëve, sidomos në ato raste kur personi ka vdekur në moshë të re dhe nga ndonjë vdekje jo e natyrshme. Edhe për mort janë krijuar një varg ritesh, zakonesh e besimesh të ndryshme. Sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit ishte zakon që miqtë, porsa të vinin këmbën në katundin e të vdekurit, do të vinin në krye jakëzat e gjurdijave. Kanun “asht me ba gjamë mbi të deknin tri herësh, tuj persritun fjalët ‘i mjeri un’” nëntë herë. Kur niset dikush për mort, nuk thotë “Lamtumirë”, as i thotë dikush “Udha e mbarë”. Sipas traditës popullore, dhembjen për të vdekurin nuk e shprehin vetëm anëtarët e familjes dhe të afërmit, por edhe qeniet e tjera të gjalla, si bagëtia, shpendët etj. Për organizimin e ceremonive mortore, ka qenë i zakonshëm solidarizimi me familjen e të vdekurit jo vetëm në pikëllim e dhembje, por edhe në përkrahje materiale (me sigurimin e ushqimit dhe vendosjen e miqve që merrnin pjesë në mort). (Bashkim Lajçi)

MOTRONI Luciano (1905-1989). Mjek, kirurg i përgjithshëm. Lindi në Livorno të Italisë, studimet i kreu në Romë (1930). Një kohë të shkurtër punoi si kirurg në Romë, pastaj profesionin e kirurgut e vazhdoi në Durrës. Në shkurt të vitit 1942 vjen në Prizren, ku jetoi deri në vdekje. Punoi si kirurg në Spitalin e Prizrenit, deri në pensionim në vitin 1974. Gjatë karrierës së vet 32- vjeçare të punës

në Spitalin e Prizrenit pa orar të caktuar kreu operacione të ndryshme jo vetëm në lëmin e kirurgjisë, por edhe të ortopedisë, urologjisë dhe gjinekologjisë. U shqua gjithashtu në ngritjen profesionale të kuadrit të ri mjekësor. Si kirurg aktiv punoi deri në vitin 1969, kur edhe filloi t'i dobësohet të shikuarit. Vdiq në Prizren. (Avdyl Krasniqi)

MOZAIKU I ORFEUT. Mozaik i zbuluar në vitin 1984 në Gllamnik të Podujevës, si pjesë e kompleksit të mozaikëve të dyshemesë me ornamentim gjeometrik të godinës së periudhës



MOZAIKU I ORFEUT NË GLLAMNIK TË PODUJEVËS

romake. Kompozicioni mozaikal i Orfeut u zbulua rastësisht në thellësi prej 40 cm (1985). Është mjaft i ruajtur, pos pjesës së epërme të kornizës me ornamentim gjeometrik, këndit të poshtëm të majtë dhe një pjese të gjuri i majtë i Orfeut (2 x 1.40 m). U punua me teknikë opus tessellatum, në sfond me tesera të bardha, me emër të Orfeut me tesera në të kaltër të mbyllur dhe me paraqitjet figurative me kombinimin e tesarave me ngjyrë të kuqe, të kaltër të mbyllët, të verdhë dhe oker. Korniza katërkëndëshe e fushës mozaikale është punuar me kombinimin e brezave të bardhë dhe të kaltër të mbyllët dhe gërshetës tringjyreshe në mes (kuq, kaltër, verdhë). Në qendër gjendet Orfeu i ulur mbi shkëmb dhe i rrethuar me shtazë të egra dhe vegjetacion (leopard, luan, gjarpër, zog, pemë), të ndalur para fuqisë magjike të tingujve të poetit dhe muzikantit të parë mitik. Trupin e ka të kthyer

në të djathtë, në dorën e majtë mban lyrën dhe në të djathtën stilosin. Ka të veshur fustan të shkurtër oriental ngjyrë të kaltër të mbyllët me shumë palë, të mbërthyer në bel me brez të kuq. Mbi fustan ka tunikë të kuqe, e cila ia mbulon shpinën dhe shpatullat dhe në kokë ka kapelë frigiase. Krishterimi i hershëm e përvetësoi Orfeun, të vetmin nga figurat pagane, që ta prezantojë Krishtin si “Bari të Zotit”, në kohën kur krishterimi ende ndiqej, siç paraqitet edhe në katakombet e Romës. Kjo dëshmohet dhe nga mozaiku i Bosnjës, gati identik me mozaikun e Vendenisit, por ku Orfeu e ka të paraqitur kryqin në llërën e dorës së majtë. Në mozaikun pak më të vonë dhe më të sofistikuar të Durrësit, Orfeu është i kthyer në të majtë dhe rrethohet me shtazë të zbutura. Mozaiku pagan i Orfeut nga Gllamniku i takon shek. III dhe është shprehje e përparimit ekonomik dhe kulturor në Dardani. Aktualisht mozaiku gjendet në Beograd. Prezenca e vendbanimit të pasur dhe i nekropolit të periudhës romake në Gllamnik është konstatuar që nga vitet 50 të shek. XX, andaj arkeologu E. Çershkov në të e ubifikoi Vendenisin, të shënuar për herë të parë nga Ptolomeu (shek. II) dhe të shënuar më pas dhe si Vindenis (Tabula Peutingeriana) e Vindinis (Anonimi nga Ravena). (Edi Shukriu)

MOZAIKU I SHTATË MENDIMTARËVE. Mozaik polikrom me figura të shtatë mendimtarëve, i vendosur në kompleksin arkitektonik antik në Nerodime të Poshtme (Ferizaj, 1988). U gjet në hapësirë prej 8.5 x 8 m dhe është punuar me tesere me ngjyrë të kaltër, të gjelbër, të bardhë, të kuq, të zi dhe me nuancat e këtyre ngjyrave. Në të janë paraqitur shtatë mendimtarë antikë, nga të cilët është ruajtur vetëm një. Emrat e tyre janë të shkruar në katër rreshta horizontale në gjerësinë e mozaikut në gjuhën latine: Periandri (Korinth), Chiloni (Spartë), Soloni (Athinë), Talesi (Milet), Pitacusi (Mitilen), ndërsa emrat e dy mendimtarëve të tjerë nuk mund të lexohen. Figurat janë vendosur nën arkada të dekoruara dhe mozaiku është përshkruar me ornamente vegetative dhe florale, si dhe me bordura kornizuese. Është punuar në mënyrë të perfeksionuar dhe paraqet ekzemplar të rrallë artistik në Dardani. Kompleksi me mozaikun i takon shek. IV-V dhe mund të ketë qenë pronë e ndonjë aristokrati, që ka shërbyer si vilë për pushime. (Fatmir Peja)

MRAMORI Hamdi (1895-1944). Veprimtar i rezistencës antikomuniste. Lindi në Mramor të Prishtinës. Që nga viti 1920 u anëtarësua në organizatën politike “Xhemiet”. Ra në konflikt me pushtetin, kundërshtoi shpërnguljen e shqiptarëve për në Turqi dhe kolonizimin e Kosovës. Bashkëpunoi me Nazim Gafurrin e veprimtarë të tjerë të çështjes kombëtare. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, deri më 1943, ishte kryetar komune në Graçanicë. Nga fillimi i vitit 1944 ishte komandant i njësiteve vullnetare në Keqekollë dhe Prapashticë për mbrojtjen e kufirit nga njësitë partizane bullgare-serbe. Pas depërtimit të njësiteve partizane në Kosovë, në nëntor të vitit 1944 iu bashkua forcave të rezistencës, të udhëhequra nga Adem Gllavica. Mori pjesë në luftën për çlirimin e Ferizajit nga pushteti komunist dhe u vra në ditën e parë të betejës (2 dhjetor 1944). (Zijadin Gashi)

MRAMORI. Fshat në komunën e Prishtinës, rreth 12 km në lindje të saj. Shtrihet në pjesën lindore të masivit malor të Gërmisë, në sipërfaqe prej 54 km² dhe rreth 1,600 banorë. Me Prishtinën lidhet nëpërmjet tri grykave të lumenjve. Rruga më e shkurtër për këmbësorë është ajo që shpie nëpër grykën e Përroit të Butovcit, tjetra kalon nëpër luginën e Suteskës dhe lidhet me rrugën magjistrale Gjilan-Prishtinë, ndërsa e treta është ajo që kalon nëpër qafën e Bunarit të Dukës dhe në drejtim të veriut dhe lidhet me rrugën Prishtinë-Keqekollë. Popullsia e Mramorit veçohet për mobilitet të vogël hapësinor, pjesëmarrje të lartë të popullsisë së re, nivel relativisht të ulët arsimor, pjesëmarrje të ulët të popullsisë aktive etj. Nga objektet shoqërore, fshati ka shkollën fillore dhe stacionin shëndetësor. (Nazif Gashi)

MRASORI Naser (1973-). Studiues i letërsisë, gjermanist. Lindi në fshatin Mrasor, shkollimin fillor dhe të mesëm e kreu në Klinë, ndërsa studimet për gjuhë dhe letërsi gjermane në Universitetin e Prishtinës (UP). Në vitin 2001 kreu studimet pasuniversitare, ndërsa tezën doktoratës “Vepra e Stefan Cvajgut dhe receptimi i saj në letërsinë shqipe” e mbrojti më 2005 në UP. Nga viti 2002 punon në departamentin e gjuhës dhe letërsisë gjermane të Fakultetit të Filologjisë të UP-së. Në vitet 2000-2009 punoi në Ambasadën e Zvicrës në Prishtinë dhe më pas (2009-2012) ishte prorektor për bashkëpunim ndërkombëtar në Universitetin e Prishtinës. Në

periudhën 2013-2015 ishte rektor i Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë. Në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Kosovës ka mbajtur disa funksione, kryesisht nga fusha e bashkëpunimit shkencor ndërkombëtar. Është autor i disa punimeve shkencore të botuara brenda dhe jashtë vendit dhe i monografisë “Kur Stefan Cvajgu na flet shqip”. (Blerta Ismajli)

MREKULLITË E SHËN DHIMITRIT (Miracula-Demetrius Sanctii). Burime hagiografike, të njohura si burime më të rëndësishme të historisë së hershme mesjetare të Ballkanit. Janë vendosur në vargun e “veprave jotradicionale të letërsisë historike bizantine”. Përveç njoftimeve që i referohen shenjtorit Dhimitër dhe kultit të tij, ofrohet një spektër i gjerë i lajmeve kushtuar Bizantit, sllavëve, avarëve si dhe marrëdhënieve të tyre. Vëmendjen e historianëve e kanë tërhequr kryesisht dy tekste nga gjithë korpusi i veprave të mrekullive të shenjtorit: *Miracula sancti Demetrii prima* (në mes të viteve 610 dhe 620) dhe *Miracula sancti Demetrii secunda* (nga vitet 20 të shek. VII). Tekstet ofrojnë njoftime të rëndësishme për gjithë Bizantin, si dhe për dyndjet sllave e avarë dhe, në këtë kontekst, edhe për qytetet e provincës së Dardanisë (Nishi dhe Sardika) përballë rrethimeve dhe shkatërrimeve të tyre (rreth viteve 615-618). Vlera shkencore e njoftimeve që dalin nga ky burim janë të një rëndësie të madhe, meqë këtu dëshmohet prania e konceptit gjeografik dhe shtetëror të Dardanisë në mesjetën e hershme. Provinca e Dardanisë, si dhe provincat e tjera ballkanike të Perandorisë Bizantine, nga fillimet e shek. VII ishin jashtë horizontit të historiografisë bizantine, meqë atëbotë vëmendja ishte përqendruar te rreziqet që kërcënonin drejtpërdrejt Konstandinopojën. (Jahja Drançolli)

MUÇAJ Afrim (1987-). Aktor. Lindi në Prizren. Shkollën fillore e kreu në Korishë, ndërkaq të mesmen në Prizren dhe Prishtinë. Kreu studimet për aktrim në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës (2011). Fillimisht në Teatrin “Loja”, luajti në shfaqjen “Këmisha e gjakut”, më pas në Teatrin e Prizrenit në shfaqjet “Një letër e humbur” dhe “Shërbëtori i dy zotërinjve”. Në Teatrin “Dodona” ka luajtur në shfaqjet “Zemër e vetmuar” dhe “Menaxheria e qelqtë”, ndërkaq në Qendrën Multimedia në shfaqjen “Shkolla e vogël e kujtimeve”. Në Teatrin Kombëtar të Kosovës luajti në shfaqjet:

“Përplasjet” dhe “Ferma e kafshëve”. Ka luajtur edhe në disa filma të metrazhit të gjatë, si “Gomarët e kufirit”, “Kodi i jetës”, “Ada”, “A dream”, si dhe në disa filma të metrazhit të shkurtër (“Ndëshkimi”, “Zibidi”, “Ballkoni”, “Toka”, “Maja”). Ka luajtur edhe në serialin televiziv “Stinë dashurie”. (Bekim Lumi)

MUÇAJ Arta (1974-). Aktore. Lindi në Prizren. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Prishtinë. Kreu studimet për aktrim në Akademinë e Arteve të Bukura në Tiranë (1997).



ARTA MUÇAJ

Filloi krijimtarinë artistike si aktore në Teatrin Kombëtar të Tiranës (Shqipëri), ku në vitet 1995-1999, me role të ndryshme, luajti në shfaqjet: “Gënjeshtari”, “Vdekja e Dantonit”, “Quo Vadis”, “Ditë vere” dhe “Kujdes, kafshon!”.

Në periudhën 1999-2010 punoi në Teatrin Kombëtar të Kosovës, ku luajti kryesisht role kryesore në shfaqjet: “Fluturimi mbi follenë e qyqes”, “Faust III”, “Vdekja dhe vasha”, “Kutia e zezë”, “Roberto Zuko”, “Shtëpia e Bernarda Albës” dhe “Rebelët”. Luajti gjithashtu në Teatrin e Gjakovës në shfaqjet: “Hanibali i nëntokës” dhe “Hiqe ministrin nga priza”, në Teatrin Shqiptar të Shkupit në shfaqjet: “Babai” dhe “Dervishi dhe vdekja” etj. Luajti edhe në disa shfaqje jashtë vendit, si: “Nesër nisemi në parajsë” në Stokholm (2000) dhe “Hotel Europa” në Vjenë (2001). Nga viti 2010 jeton dhe vepron në Australi, ku në Melburn dhe në Sidnej luajti në shfaqjet “Kthimi i Helenës”, “Duaje fqinjin” dhe “Shekspiri dhe zonja e errët e sonatave”. Krahas teatrit, luajti edhe në filma të metrazhit të gjatë “Vjeshta e trëndafilave”, “Anatema” dhe “Gomarët e kufirit”. U nderua me çmime të ndryshme për kreacione artistike në teatër dhe në film. (Bekim Lumi)

MUÇAJ Bislim (1951-). Aktor. Lindi në Kabash të Prizrenit. Mbaroi studimet për aktrim në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prishtinë më 1972. Gjatë viteve 70 punoi si aktor në Teatrin Popullor të Gjakovës, ndërsa prej vitit 1985 në Teatrin Popullor Krahinor. Aktrimin e tij e karakterizon një diksion i pastër dhe me ngjyrimet të pasura intonative dhe ekspresion i fuqishëm emocional. Realizoi një sërë rolesh,



BISLIM MUÇAJ

një numër syresh role kryesore. Më të realizuarat prej tyre konsiderohen: Kabili te “Sfinga e gjallë” (1977) në regji të S. B. Krasniqit, Princi te “Princi i hijeve” në regji të A. Sopit (1985), Mulla Jusufi te “Dervishi dhe vdekja” në regji të V. Milçinit (1985), Vurmi i ri në “Intrigë e dashuri” në regji të P. Dinullotoviqit (1985), Shtjefën Gjeçovi te “Lkeni i Hasit” në regji të M. Qenës (1986), Leci te “Vdekja me vjen prej syve të tillë” në regji të F. Hysajt (1989), Lulani te “Gof” në regji të Xh. Qorrajt (1994). Realizoi kreacione të suksesshme edhe në shfaqjet: “Shfaqja e fundit” (2001), “Bodrumi”, “Grafitet” (2016). Pos në teatër B. Muçaj realizoi edhe një sërë rolesh në filmat artistikë: “Kur pranvera vonohet” (1979), “Njeriu prej dheu” (1983), “Rojet e mjegullës” (1987), “Përroi vërshues” (1989), “Era e mollës” (1985), “Vjeshta e trëndafilave” (2001), “Kur shpirti ndërrohet jetë” (2002), “Kukumi” (2004) etj. Realizoi edhe dhjetëra role të tjera në filma të metrazhit të shkurtër. Për filmin “Sakica” mori çmimin e parë në Festivalin “9/11”. Më 2016 mori Çmimin e Karrierës nga Ministria e Kulturës e Kosovës. (Fadil Hysaj)

MUÇAJ Hysnije (1952-). Aktore. Lindi në Krushë të Madhe të Rahovecit. Shkollimin fillor e kreu në vendlindje, shkollën e mesme në Prizren, ndërsa studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe i kreu në Prizren dhe në Prishtinë. Në Tetarin e Gjakovës punoi në vitet 1981-1985. Më pas u inkadrua në Teatrin Popullor Krahinor, ku punoi si menaxhere e baletit deri më 1989, pastaj kaloi si aktore e rregullt në ansamblin e dramës. Luajti role në shfaqjet: “Agu” i D. Mehmetit, “Pirrua” i Y. Shkrelit, “Unë Halil Garria” të B. Musliut, “Burrri burrë” të K. Floçit, “Cub i kukurrecit” të R. Ramabajës, “Fejesa” e K. Manjesë dhe “Servisi i shpirtit” të D. Demakut. Aktroi edhe në filmat “Proka”, “Kulla” dhe “Migjeni”. (Selman Jusufi)

MUÇAJ Mustafë (1957-). Moderator, gazetar. Lindi në Korishë të Prizrenit. Shkollën fillore dhe të mesme i mbaroi në Prizren, kurse studimet në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës. Si fëmijë ishte shpallur recituesi

më i mirë në garat e atëhershme federative të ish-Jugosllavisë në Trebinje të Bosnjës. Punën e filloi në Radiotelevizionin e Prishtinës (RTP) si spiker dhe moderator. Pas mbylljes së RTP-së në korrik të vitit 1990 u angazhua në redaksinë e RTP-së që përgatiste programe informative për Kosovën nga Televizioni Shqiptar. Nga viti 2000 punon moderator dhe gazetar në Radiotelevizionin e Kosovës. Ka realizuar edhe disa dokumentarë televizivë. (Shaqir Foniqit)

MUÇAJ Nimon (1952-). Aktor, regjisor, shkrimtar. Lindi në Llukë të Epërme të Deçanit. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Deçan, studimet për gjuhë dhe letërsi angleze i



NIMON MUÇAJ

kreu në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës, ndërkaq studimet për aktrim në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prishtinë. Punoi si mësues i gjuhës angleze në Drenoc dhe Isniq të Deçanit. Më pas, nga viti 1977 punoi si aktor në Teatrin Popullor të Gjakovës. Disa vjet ishte drejtor i Teatrit të Qytetit “Istref Begolli” në Pejë. Luajti në role dhe shfaqje të ndryshme, nga të cilat veçohen: “Nora”, “Ngjarja në Vishi”, “Plaku i maleve”, “Toka jonë”, “Fisheku në pajë”, “Besa”, “Intrigë e dashuri”, “Njeriu me top”, “Unë Halil Garria”, “Beselam pse më flijojnë”, “Babai im kullak socialist”, “Halili e Hajria”, “Hëna prej letre”, “Lahuta e Malcis”, “Aleksandër Moisiu”, “Antigona”, “Si e mposhta Musolinin”, “Një varr për majorin e Mbretit”, “Epoka para gjyqit” etj. Ka bërë edhe regjinë e disa shfaqjeve me trupat amatore në Deçan, Gjakovë etj. Përveç në teatër, luajti edhe në filmat artistikë: “Kur pranvera vonohet”, “Njeriu prej dheu”, “Rojet e mjegullës” dhe “Kukumi”, pastaj në filmat televizivë: “Era dhe Lisi”, “Kulla”, “Era e mollës”, “Migjeni” etj. Është autor i disa dokumentarëve televizivë. Shkroi edhe disa vepra në prozë (“Prova e tridhjetet-retë”, “Vdekja e kalit”, “Baladë për borën e kuqe” etj.), si dhe disa drama dhe libra monografikë. U nderua me çmime të ndryshme në festivalet teatrore, si dhe me disa çmime letrare. (Naime Beqiraj)

MUÇIBABA. Fshat në komunën e Gjilanit, në rajonin e Anamoravës, vendbanim kodrinor-

malor i tipit të shpërndarë. Shtrihet në malet e Karadakut në lartësi mbidetare 810 m. Është vendbanim kufitar ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Serbisë. Nëpër qafën e Muçibabës (880 m) kalon rruga magjistrale që lidh Gjilanin dhe Anamoravën me Luginën e Preshevës. Pozita kufitare dhe periferike, si dhe lufta e fundit ndikuan në shpërnguljen e popullsisë me përmasa të shpopullimit. Derisa në vitin 1948 në këtë fshat kanë jetuar 375 banorë, në vitin 2011 këtu jetojnë vetëm 80 banorë. Blegtoria, bujqësia ekstensive dhe pylltaria janë aktivitetet kryesore ekonomike të popullsisë së fshatit. Ka shkollën 9-vjeçare. (Nexhat H. Rexha)

MUÇIVËRCA. Fshat në juglindje të Kamenicës, rreth 7 km nga qendra komunale. Shtrihet në anën e majtë të lumit të Hogoshtit, në lartësi mbidetare 470 m. Si vendbanim me 6 shtëpi përmendet në defterin kadastral osman të vilajetit Vëllk të vitit 1455. Në vitin 1948 kishte 743 banorë, kurse në vitin 2011 janë regjistruar 1,520 banorë rezidentë. Veprimtari kryesore ekonomike është bujqësia. Në fshat vepron shkolla 9-vjeçare. (Muhamed Kallaba)

MUÇOLLI Arif (1952-). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), komandant brigade në Zonën Operative të Llapit. Lindi në fshatin Herticë të komunës së Podujevës. Kreu studimet për pedagogji në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Gjatë shërbimit ushtarak në ish-ushtarinë jugosllave kreu edhe shkollën e oficerëve rezervë. Punoi në arsim në Herticë dhe në Podujevë. Me përfundimin e vitit shkollor 1997/98, bashkë edhe me shumë ish-nxënës të tij, u rreshtua në radhët e UÇK-së në Zonën Operative të Llapit, në fshatin Bajgorë të Shalës. Në fillim u emërua zëvendëskomandant i brigadës dhe deri në shtator të vitit 1998 punoi në stërvitjen dhe përgatitjen ushtarake të vullnetarëve të rinj në UÇK. Në dhjetor të vitit 1998 u emërua komandant i Brigadës 152 “Shaban Shala”, detyrë që e kreu deri në përfundim të luftës dhe deri në transformimin e UÇK-së. (Ismet Cakiqi)

MUÇOLLI Isak (1940-2015). Violinist, kompozitor. Lindi në Bajçinë të Podujevës. Shkollën e Mesme të Muzikës e kreu në Prizren (1961), kurse shkollimin e lartë, drejtimi instrumental për violinë, në Beograd. Me t'u

kthyer në Prishtinë nisi punën si udhëheqës i Orkestrës Popullore të Radiotelevizionit të Prishtinës, detyrë që e kreu deri në mbylljen e këtij institucioni nga pushteti serb më 1990. Pas themelimit të Orkestrës simfonike të Radiotelevizionit të Prishtinës, deri në mbyllje, ishte anëtar i saj, një kohë të gjatë koncert mjeshtër, kurse pas mbarimit të luftës, në vitet 2000-2012 anëtar i Filarmonisë së Kosovës. La gjurmë të pashlyeshme për muzikën kosovare si instrumentist dhe udhëheqës orkestre, si aranzhues i shumë këngëve dhe kompozitor. Ishte bashkëthemelues i festivaleve “Akordet e Kosovës”, “Zambaku i Prizrenit” dhe “Kosovarja këndon”. Ka kompozuar këngë me motive popullore të realizuara në festivale e manifestime. Shumë prej tyre janë shpërblyer. Ishte tri herë fitues i “Okarinës së artë” në Festivalit “Akordet e Kosovës”. (Kristina Palokaj-Përkola)

MUÇOLLI Ramadan (1955-). Gazetar. Lindi në Bajçinë të Podujevës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, gjimnazin në Podujevë, ndërsa studimet për letërsi dhe gjuhë shqipe i kreu në Universitetin e Prishtinës. Nga viti 1977 deri më 1990 punoi në Radio Prishtinë, gazetar dhe redaktor i programin informativ dhe kulturor. Në periudhën 1992-1999 punoi në redaksinë për Kosovën të Radiotelevizionit Shqiptar në Prishtinë dhe në Tiranë. Njëkohësisht punoi edhe në Qendrën për Informim të Kosovës (QIK). Një kohë (1995-1996) e udhëhoqi edhe redaksinë e javores politike “ORA” që botohej në Prishtinë dhe në Gjermani. Në këtë periudhë bashkëpunoi edhe me gazeta, revista e radiostacione në gjuhën shqipe në Maqedoni, SHBA, Francë e Australi. Prej viti 1999 deri më 2009 punoi në Radiotelevizionin-21, si redaktor dhe kryeredaktor i programit informativ. Së fundi punon në gazetën shqiptaro-amerikane “Illyria”, që botohet në Nju-Jork, SHBA. Është autor i disa radiodramave, të realizuara në Radio Prishtinë e Radio-Tiranë dhe autor i disa emisioneve dokumentare. (Ibrahim Berisha)

MUÇOLLI Valina (1981-). Aktore. Lindi në Prishtinë, ku kreu shkollimin fillor dhe të mesëm. Kreu studimet për dramaturgji në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës (2014). Fillimisht luajti disa role në teatër, si në dramën “Një varr për majorin e mbretit” (2012), kurse më pas u angazhua në

Teatrin “Metropol” të Tiranës, në një numër shfaqjesh, nga të cilat duhen veçuar: “Nënë dhe bijat” (2014), “Nusja në thes” (2014) etj. Luajti edhe disa filma të metrazhit të shkurtër: “Si qeni në rrush” (2011), “Hekurishtja” dhe “Intervista” (2015) dhe në filmat e metrazhit të gjatë: “Gomarët e kufirit” (2010) dhe “Lindje Perëndim Lindje” (2015). (Besim Rexhaj)

MUFAKU Muhamed (1952-). Historian, orientalist, përkthyes dhe profesor universiteti. Lindi në Damask të Sirisë në një familje me origjinë nga Kosova. Kreu studimet themelore



MUHAMED
MUFAKU

në Damask në Fakultetin e Gjuhës dhe të Letërsisë Arabe, ndërsa studimet e pasuniversitare i kreu në degën e historisë të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës (UP). U doktorua në degën e letërsisë të Fakultetit të Filologjisë (1981) dhe në degën e historisë të Fakultetit Filozofik (1986) të UP-së. Gjatë viteve 1974-1987 punoi në Universitetin e Prishtinës, si lektor në degën e orientalistikës. Ma pas punoi si mësimdhënës në degën e historisë të Universitetit “Jarmuak” në Jordani (1989-1995) dhe në Universitetin “Al Al-Bajt” po ashtu në Jordani (1995-2012). Për një periudhë ishte drejtor i Institutit të Shkencave Politike (1995-2005) dhe drejtor i Qendrës për Studimin e Botës Islame (2006-2010). Në vitin 2002 u zgjodh anëtar korrespondent i Akademisë Arabe në Damask dhe nga viti 2010 anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Është pjesëmarrës i një sërë konferencash shkencore ndërkombëtare dhe autor i një sërë studimesh të publikuara kryesisht në hapësirën shqiptare dhe në botën arabe. Është autor i shumë veprave në shqip e arabisht nga fusha e letërsisë, e historisë dhe e publicistikës: “Antologjia e poezisë arabe” (1979), “Antologjia e poezisë bashkëkohore shqiptare e Kosovës” (1981), “Tregime siriane” (1982), “Letërsia shqipe me shkronjat arabe” (1983), “Shqiptarët në botën arabe” (1990), “Kosova epiqendra e konfliktit shqiptaroserb” (1998), “Kosova 1989 -1999” (2000), “Kosova në mes të kaluarës e të tashmes” (2008), “Kosova: refleksione kulturore midis Perëndimit dhe Orientit” (2009), “Vakëfi në

botën islame” (2011), “Ballkani: prej Orientit në orientalistikë” (2014) etj. Nga gjuha shqipe ka përkthyer në gjuhën arabe një sërë veprash. (Nuridin Ahmeti)

MUGOSHA Dushan (Dušan Mugoša) (1914-1977). Funkionar i lartë i Partisë Komuniste Jugosllave (PKJ) dhe i pushtetit jugosllav në Kosovë, i dërguar i Komitetit Qendror të PKJ-së në Shqipëri gjatë Luftës Nacionalçlirimtare (LNÇ). Lindi në Ljeshkopolje të Podgoricës në Mal të Zi. Në periudhën ndërmjet dy luftërave botërore familja e tij, si kolonizues, u vendos në rrethin e Pejës. Aty u përfshi edhe në lëvizjen komuniste (1934), ndërsa në vitin 1940 u zgjodh anëtar i PKJ-së. Mori pjesë në themelimin e Brigadës I, III, IV dhe V të Kosovës dhe kreu detyrën e ndihmësit të komisarit politik në Shtabin Operativ për Kosovë e Metohi (Dukagjin). Ishte njëri nga të dërguarit kryesor të PKJ-së në Shqipëri, për të vendosur lidhje ndërmjet lëvizjeve komuniste të të dy vendeve. Në shtator të vitit 1941 u takua në Tiranë me përfaqësuesit e grupit komunist të të rinjve të Shkodrës. Në nëntor të po atij viti mori pjesë në mbledhjen për themelimin e Partisë Komuniste të Shqipërisë. Veprimi në Shqipëri deri në shtator të vitit 1944. Së bashku me Miladin Popoviqin kishin rol ndërmjetësuesi midis partive komuniste dhe lëvizjeve nacionalçlirimtare në Shqipëri dhe në Jugosllavi dhe luajtën rol të rëndësishëm për zbatimin në Shqipëri të një vije të njëjtë politike dhe ushtarake me atë të PKJ-së dhe të LNÇ-së në Jugosllavi. Në maj të vitit 1945 u rikthye në Kosovë, ku u ngarkua me detyra të rëndësishme. Në periudhën 1945-1965 ishte sekretar i Komitetit Krahinor të PKJ-së për Kosovë dhe njëra ndër figurat kryesore në zbatimin e politikës antishqiptare në Jugosllavi. (Daut Bislimi)

MUHADRI Besim (1964-). Shkrimtar. Lindi në fshatin Demjan të Hasit, komuna e Gjakovës. Kreu shkollën fillore në vendlindje, të mesmen në Gjakovë, ndërsa studimet për gjuhë e letërsi shqipe në Universitetin e Prishtinës, ku kreu dhe studimet pasuniversitare. Mbaroi studimet e doktoraturës në Qendrën e Studimeve Albanologjike në Tiranë. Që nga viti 1987 punoi si mësues në vendlindje, pastaj mësimdhënës në shkollat e mesme të Gjakovës dhe së fundi ligjërues në Fakultetin e Edukimit në Gjakovë. Shkruan poezi, prozë, kritikë

letrare, publicistikë. Deri më tash botoi një sërë veprash nga këto fusha: “A harrohet fytyra e nënës” (1999), “Rrënuesit e vendit tim” (2000), “Dhuna dhe liria në poezinë e Din Mehmetit” (2008) si dhe librin me studime dhe kritika letrare “Tradita hasjane e shkrimit shqip” (2009). (Hasan Hasani)

MUHARREMI Agnesa (1985-). Skenografe, piktoe. Lindi në Pejë. Kreu shkollimin fillor e të mesëm në Prishtinë, ndërsa studimet për skenografi në Fakultetin e Arteve në Prishtinë (2006). Mbrojti tezën e disertacionit të doktoratës në Qendrën për Studime Arti në Tiranë (2016). Nga viti 2009 është e angazhuar si ligjëruese në Fakultetin e Arteve. Ka botuar shkrime në revista dhe gazeta dhe është pjesëmarrëse në konferenca shkencore dhe ekspozita kolektive. Përveç skenografisë së teatrit dhe filmit, merret me kostumografi. Ka hapur disa ekspozita personale dhe ka realizuar skenografi e kostumografi për disa shfaqje teatrore. (Zeni Balazhi)

MUHARREMI Hivzi (1948-). Historian dhe kritik arti. Lindi në Pejë. Kreu shkollën fillore dhe gjimnazin në vendlindje, ndërsa studimet për histori të artit në Fakultetin Filozofik në



HIVZI
MUHARREMI

Beograd (1974), ku kreu dhe studimet pasuniversitare. Mbrojti tezën e disertacionit të doktoratës në vitin 1995. Punoi si mësues në Shkollën e Mesme të Artit në Pejë (1974-1980), ndërsa nga viti 1981 u zgjodh mësues në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës (UP). Në vitet 1986-1990 ishte drejtor i Teatrit Popullor në Pejë. Në disa mandate ishte dekan i Fakultetit të Arteve të UP-së dhe kreu edhe detyra të tjera në organet udhëheqëse të këtij universiteti. Në periudhën 1966-2011 mbajti mësim edhe në Universitetin e Tetovës dhe më pas në kolegje universitare private në Prishtinë dhe në Tiranë. Gjatë viteve '80 ishte anëtar i organizatave profesionale të historianëve të artit të ish-Jugosllavisë, përfshirë edhe anëtar i kryesisë së Lidhjes së Historianëve të Artit të Jugosllavisë (1992), pastaj kryetar i shoqatës për ruajtjen e trashëgimisë kulturore-historike të Pejës dhe kryeredaktor i revistës “Ars Poe-

tica”. Nga viti 1976 ishte kurator ekspozitash, si: në Zagreb, Sombor, Varazhdin, Lubjanë, Murska Sobota etj. Është autor i një sërë vështrimesh kritike dhe eseistike për ekspozitat e arteve pamore. Botoi disa libra nga kjo fushë, përfshirë monografi dhe përmbledhje tekstesh kritike dhe eseistike: “Pasqyrë e shkurtër e historisë së artit” (1983) “Metamorfozat e gjuhës figurative” (1986), “Vlada Radoviqi” (1986), “Muslim Mulliqi” (2000) “Arti Bashkëkohor i Kosovës” (bashkautor, 2000), “Qasja vizuale e arteve pamore” (2015), “Sali Gjuka” (2016) etj. Është autor i teksteve shkollore për nivele të ndryshme të shkollimit. (Hajrush Fazliu)

MUHARREMI Ilir (1983-). Dramaturg, mësimdhënës. Lindi në Pejë. Shkollën fillore e kreu në Prishtinë, ndërsa Shkollën e Mesme të Artit në Pejë. Studimet për aktrim i kreu në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës (UP) në vitin 2004. Po në këtë fakultet, më pas kreu studimet pasuniversitare në degën e dramaturgjisë dhe më pas mbrojti tezën e disertacionit të doktoratës në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Shkupit (2010). Është autor i dramave “Van Gogu kosovar” (2010), “Unë me veten” e “Kafeneja” (2013) dhe i përmbledhjeve me poezi “Djali në qytetin tim” (1996) dhe “Dera e fundit e çmendurisë” (2003). Është mësues në Fakultetin e Edukimit të UP-së. Shkruan edhe ese dhe tekste kritike për dramën, teatrin, filmin, artin pamor dhe atë konceptual etj. (Besim Rexhaj)

MUHAXHERI Agim (1954-). Gazetar. Lindi në Skënderaj. Shkollën fillore e kreu në Gjiilan, gjimnazin në Kaçanik dhe Fakultetin Juridik në Universitetin e Prishtinës. Gazetar në “Rilindje” ishte nga viti 1982. Gjatë punës si gazetar, shkroi fejtone për fenomene të ndryshme të delikuencës së të rinjve, raporte për procese gjyqësore etj. Raportoi për proceset gjyqësore dhe vrasjet e ushtarëve shqiptarë që shërbenin në ushtrinë jugosllave etj. Publikoi edhe shkrime të karakterit shkencor në revistën “E drejta”. Pas luftës, pos në “Rilindje”, punoi edhe në gazetat “Dita”, “Lajmi”, “24 orë”, “Epoka e re”, “Tribuna” dhe “Zëri”. (Muhamet Mavraj)

MUHAXHERI Murat (1892-1937). Mësues atdhetar. Lindi në Gjakovë. Pas arsimit fillor në vendlindje, kreu Normalen e Shkupit (1911), pastaj kursin pedagogjik në Berat (1913). Fillimisht ishte mësues në Gjakovë,

pastaj nëpunës në Drejtorinë e Arsimit në Vlorë (1913). Gjithashtu, ishte mësues në Krujë, në Gjakovë dhe në Pejë (1914-1918). Ishte anëtar i shoqërisë arsimore atdhetare, "Besa Kombëtare", anëtar i Komitetit Mbrojta Kombëtare e Kosovës, sekretar i gazetës "Populli". Në vitet 1921-1922 ishte mësues në Krujë, pastaj inspektor arsimit, mësues dhe drejtor shkollë në Kavajë dhe në Lushnje (1925). Ishte pjesëmarrës në lëvizjen demokratike dhe drejtues i degës së shoqërisë "Bashkimi" në Krujë e Kavajë. Për shkaqe politike mërgoi në Vjenë dhe në fillim të vitit 1930 u kthye në Shqipëri dhe punoi në Kavajë. (Jusuf Meqa)

MUHAXHERI Mustafë (1952-). Inxhinier i makinerisë, profesor universiteti. Lindi në Pejë, ku kreu shkollimin fillor dhe të mesëm. Kreu studimet në Fakultetin e Makinerisë dhe



MUSTAFË
MUHAXHERI

të Anijendërtimit të Universitetit të Zagrebit (1976). Studimet pa-universitare i përfundoi po në Universitetin e Zagrebit (1983). Në periudhën 1978-2008 punoi në Entin për Urbanizëm dhe Projektim në Pejë. Disertacionin e mbrojti në Fakultetin e Makinerisë të Universitetit të Sarajevës (1991). Punoi një vit në Universitetin Teknik të Kopenhagës në Danimarkë. Në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike ligjëroi lëndët pajisjet e ftohjes, gazrat teknike, pompat termike dhe enët nën presion. Ka bërë ekspertizë në fushën e burimeve të ripërtërishe të energjisë dhe eficientës energjetike. Është autor i teksteve universitare "Pajisjet e ftohjes" (1998) dhe "Përmbledhje detyrash nga pajisjet e ftohjes". (Xhemajl Fejzullahu)

MUHAXHIRI Halil (1945-2013). Pikturor. Lindi në Gjakovë. Shkollimin fillor dhe të mesëm i kreu në vendlindje, studimet për pikturë në Akademinë e Arteve në Beograd (1970). Është pikturor ekspresionist dhe i njohur si krijues i figuracionit kompozicional abstrakt dhe monumental. Nga viti 1974 ishte mësimdhënës i lëndëve vizatim, teknologjia e pikturës dhe pikturë monumentale në Fakultetin e Arteve në Prishtinë. Ishte anëtar aktiv i Shoqatës së Artistëve Figurativë të Kosovës nga viti 1973. Organizoi disa ekspozita personale në Beograd

(1971, 1973, 1974) dhe në Pozharevc (1980) dhe mori pjesë edhe në një sërë ekspozitash kolektive në Kosovë dhe jashtë saj: në Beograd, Prishtinë, Zagreb, Lubjanë, Shtutgart, Paris, Tiranë, Kozencë, Palermo, Montreal, Ankara, Stamboll, Dubrovnik, Gjakovë etj., si dhe në ekspozita të tjerë të organizuara nga shoqatat e artistëve figurativë të Serbisë dhe të Vojvodinës. Ishte fitues i disa çmimeve dhe mirënjohjeve. (Hajrush Fazliu)

MUHAXHIRI Qamil (Qamili i Vogël) (1923-1991). Këngëtar e kompozitor popullor. Lindi në Gjakovë. Në mungesë të kushteve për shkollim, mësoi shkrim-leximin si autodidakt,



QAMIL
MUHAXHIRI

duke arritur arsimimin elementar. Qysh si fëmijë u vërejt talenti për muzikën dhe shpejt i ra në sy mjeshtrit të sharkisë, Ymer Riza, i cili e mori në grupin e tij muzikor. Më 1952 u bë solist i programeve muzikore në Radio-Prishtinë. Njëkohësisht u aktivizua edhe si punëtor grafik në NGB "Rilindja", ku punoi deri në pension. Më 1967 e formoi në Gjakovë grupin me këngëtarë popullorë burimorë "Ymer Riza", me të cilin kultivoi këngën qytetare gjakovare, por dhe atë shkodrane, elbasanase e tiranase. Ishte producent dhe përfaqësues i shtëpisë diskografike "Jugoton" të Zagrebit, me kontribut të çmuar në përhapjen e këngës popullore. Ishte poet e kompozitor popullor, autor i rreth 40 këngëve. Botoi në Prishtinë 11 blej me këngë popullore, si: "Bylbyli në Çabrat", "Me sharkinë e Ymer Rizës", "Lulet e beharit", "Tre Hasjanët", "Flaka e zemrës", "Këndojnë bylbylat", "Fyelli i bariut", "Lule gjaku", "Këngë krenare" dhe "Lulëkuqet e dashurisë". (Krenar Doli)

MUHAXHIRI Rabisha (1965-). Gazetare. Lindi në Medvegjë. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Prishtinë, ku mbaroi edhe studimet për gazetari në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Në vitin 1983 filloi punë në Radiotelevizionin e Prishtinës (RTK), së pari si gazetare në sektorin informativ-politik e pastaj si redaktore e programit të dytë të RTK-së. Pas vitit 1990 punoi për disa redaksi dhe revista shqiptare në Kosovë. Gjatë viteve

1997-1998 ka punuar në “Radio-koha”, e cila transmetohej në satelit. Pas vitit 1999 punoi në Radiotelevizionin e Kosovës (RTK), si redaktore në redaksitë informative dhe autore e emisioneve të kontaktit, ndërsa nga viti 2010 është redaktore përgjegjëse e programit të komuniteteve në RTK. (Nehat Islami)

MUHIQ (Muhić) Ferid (1943-). Filozof, estetik, profesor universitar, akademik. Lindi në Mahoje (Zavidoviç) të Bosnjës dhe Hercegovinës, ku e mbaroi shkollën fillore, ndërsa të mesmen në Shkup. Jeton në Shkup që nga viti 1958,



FERID MUHIQ

ku mbaroi Fakultetin Filozofik, ndërsa studimet pasuniversitare dhe doktoratën (1980) nga fusha e filologjisë dhe e filozofisë i mbaroi në Universitetin e Beogradit. Karrierën universitare e filloi si asistent në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Shkupit. Në periudhën 1976-1980 arriti gradat akademike të profesorit të asociuar dhe ordinar. Si profesor vizitor ligjëroi në shumë universitete europiane dhe amerikane. Gjatë viteve '80 dhe në fillim të viteve '90 ishte i angazhuar si bashkëpunëtor i jashtëm në katedrën filozofi-sociologji në Universitetin e Prishtinës. Që nga ajo kohë ka qenë i pranishëm në mediet vendore dhe ndërkombëtare me shkrime për Kosovën, për pozitën e shqiptarëve nën regjimin e Millosheviqit, si dhe për shkëlqjen e të drejtave të tyre në Maqedoni. U konfrontua haptas me politikën e kohës, pas vendimit të pushtetit të atjeshëm që studentëve shqiptarë t'u ndalohej mësimi në gjuhën shqipe në Fakultetin Pedagogjik në Shkup (1997). Botoi shumë vepra, nga të cilat veçohen: “Metodat e kritikizmit”, “Revolucioni dhe përpjekjet klasore”, “Motivimi dhe meditimi”, “Gjuha e filozofisë”, “Logosi dhe hierarkia” etj. Ishte kryetar i Akademisë Boshnjake të Shkencave dhe të Arteve. (Anton K. Berishaj)

MUHOCI. Vendbanim rural kufitar me Kosovën, 28 km në veriperëndim të Bujanocit. Shtrihet në të dy anët e lumit të Muhocit, degë e majtë e Moravës Jugore, në lartësi mbidetare 620 m. Për shkak të largësisë nga qendra komunale, popullsia e këtij vendbanimi graviton më shumë në drejtim të Roganës dhe Gjila-

nit. Vija kufitare vazhdon të sjellë vështirësi të shumta për banorët e fshatit, si në lëvizjen e lirë, ashtu edhe në shfrytëzimin e pronave bujqësore. Fshati ka 712 banorë (2002), ndaj 520 banorëve që janë regjistruar në vitin 1961. Muhoci, sikurse shumë fshatra të tjera të zonës kufitare me Kosovën është përfshirë nga procesi i shpopullimit, me tendenca të shuarjes së plotë. Është seli e bashkësisë lokale, në të cilin gravitojnë disa vendbanime përreth. Nga objektet e standardit shoqëror, ka shkollën 8-vjeçare, bibliotekën, qendrën e mjekësisë familjare, disa njësi tregtare etj. (Arsim Ejupi)

MUJA Alban (1980-). Pikturor, artist vizuel. Lindi në Mitrovicë. Kreu shkollimin e mesëm në vendlindje, studimet për pikturë në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës (2003). Krijimtaria e tij artistike përfshin pikturën, vizatimin, videoinstalacionin, fotografinë, performancën, filmin etj. Hapi ekspozitën e parë personale të “Hani i 2 Robertëve” në Prishtinë (2003), si dhe disa të tjera jashtë vendit. Ekspozoi në vende të ndryshme të Europës dhe të Amerikës, ku mori disa çmime dhe mori pjesë në rezidenca të ndryshme ndërkombëtare të artit nga viti 2006 e deri më sot: “International Artist Residency Braziers Park Oxford Shire England” dhe “International Artist and Writer Residency Santa Fe Art Institute USA”. (Zeni Balazhi)

MUJA Shaip (1965). Aktivist i lëvizjes çlirimtare, drejtues i sektorit shëndetësor i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Lindi në fshatin Gradicë të Drenasit. Studimet për mjekësi i filloi në Prishtinë, ndërsa i përfundoi në Tiranë më 1992. Nga viti 1984 ra në kontakt me Lëvizjen Popullore për Republikën e Kosovës. Në vitin 1990 ishte njëri nga bashkëthemeluesit e Unionit të Pavarur të Studentëve të Universitetit të Prishtinës. Një vit më vonë emigroi në Europë, më pas u kthye në Shqipëri, ku përmbylli studimet për mjekësi dhe nisi specializimin për kirurgji. Në Tiranë dhe Durrës vazhdoi aktivitetin e biznesit në fushën e farmacisë. Pas fillimit të aktiviteteve të para guerile të UÇK-së, biznesin e tij e vuri në shërbim të luftës çlirimtare. Gjatë luftës koordinoi furnizimin e UÇK-së me pajisje mjekësore dhe medikamente dhe u autorizua nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së për drejtimin e sektorit shëndetësor. Në prill

të vitit 1999 Qeveria e Përkohshme e Kosovës e emëroi koordinator shëndetësor në mes të formacioneve ushtarake dhe civile, detyrë që e ushtroi deri në qershor të vitit 1999. Pas çlirimit të Kosovës u emërua komandant i njësisë shëndetësore emergjente të Trupave Mbrojtëse të Kosovës (Batalioni 40) (1999-2002). Në fund të vitit 2002 formoi Qendrën e Telemjekësisë në Kosovë dhe deri më 2007 ishte drejtor i kësaj qendre. Nga viti 2010 është deputet i Kuvendit të Kosovës. (Sylë Ukshini)

MUJAJ Hasan (1947-). Gjuhëtar, profesor. Lindi në Dugaivë, komuna e Pejës. U diplomua për gjuhë dhe letërsi shqipe më 1973 në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës, ku më pas kreu studimet pasuniversitare dhe mbrojti tezën e disertacionit të doktoratës (1993). Mban titullin universitar të profesorit të rregullt. Ishte prodekan dhe më pas dekan i Fakultetit të Edukimit në Prishtinë, prodekan i Fakultetit të Edukimit në Gjakovë dhe ushtrues detyre i rektorit të Universitetit të Gjakovës. Botoi gjashtë vepra nga fusha e gjuhësisë dhe shumë kumtesa, kritika, recensione, reagime. Merret me shqipen e sotme. Nga veprat e botuara veçojmë: “Stilistika gjuhësore në epikën kreshnike” (2003), “Gjuhësia e tekstit” (2004), “Kërkime sociolinguistike” (2012) etj. (Naser Pajaziti)

MUJOTA Fehmi (1963-). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), politikan. Lindi në Mollopolc të Shtimes. Kreu shkollën e mesme në Prizren, ndërsa studimet për sociologji-filozofi i mbaroi në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës (1990). Punoi si mësimdhënës në shkollat e mesme në Shtime (1993-1998). Në vitin 1990 ishte njëri ndër ideatorët e themelimit të Unionit të Pavarur të Studentëve. Gjatë viteve 1990-1993 u angazhua në Këshillin për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut dhe në komisionin për informim të degës së Lidhjes Demokratike të Kosovës në Shtime. Kontaktet e para me përfaqësues të UÇK-së i vendosi në vitin 1993 në Tiranë. Në mars të vitit 1998 iu bashkua UÇK-së në Zonën Operative të Nerodimes. Pas luftës kreu detyra me përgjegjësi në institucionet e Kosovës kryetar i komunës së Shtimes nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës (2000), më pas deputet i Kuvendit të Kosovës (2004-2007), ministër i Forcës së

Sigurisë së Kosovës (2008), më vonë ministër i Ministrisë së Infrastrukturës etj. (Ali Uka)

MULA Avni (1928-). Këngëtar bariton, kompozitor, Artist i Popullit. Lindi në Gjakovë, kurse arsimin fillor e të mesëm i kreu në Shkodër, ku ra në sy për talentin muzikor.



AVNI MULA

Pjesëtar i Ansambllit të Ushtrisë dhe i Ansambllit Kombëtar të Këngëve dhe Valleve Popullore. Kreu studimet në Konservatorin “P. I. Çajkovski” të Moskës, ku u diplomua si këngëtar lirik në vitin 1957. U aktivizua në Teatrin e Operës dhe të Baletit, duke realizuar role kryesore të repertorit operistik të kohës dhe u dallua për nivelin e lartë muzikor e skenik. Veçohen rolet: Figaro nga opera “Berberi i Seviljes” e Rosinit; Onjegini nga “Eugjen Onjegin” e Çajkovskit; Gjeto nga opera e parë shqiptare “Mrika” e P. Jakovës. Zhvilloi veprimtari të pasur koncertore brenda e jashtë vendit. Veprimtarinë krijuese e nisi në gjysmën e dytë të viteve ‘60 në fushën e këngës e të romancës dhe më pas si autor i veprave të mëdha, si opera, kantata e poema vokale, instrumentale e skenike. Ka qenë themelues e pjesëmarrës i Festivalit të Këngës në Radiotelevizionin Shqiptar që nga viti 1962 me këngën “Këndo”. Ndër krijimet e tij veçohen opereta “Karnavalet e Korçës” (1978) dhe opera “Borana” (1984). Ka shkruar muzikën e filmave: “Lumë drite” (1975), “Udhëtim në pranverë” (1975), “Balonat” (1979), “Karnavalet” (1980), “Fejesa e Blertës” (1984), si dhe është kompozitor i këngëve të njohura si “Valsi i lumturisë”, “Këngët e atdheut tim”, “Nënë moj, do pres gërshetin”, “Një djep në barrikadë” etj. Pjesë e veprimtarisë së tij artistike ka qenë dhe kontributi si publicist në organet e shtypit shqiptar. Ka marrë dhjetëra çmime artistike për interpretime dhe krijimtari muzikore, si dhe “Çmimin e Republikës” të shkallës I dhe “Urdhrin e Flamurit” të kl. I. Në 80-vjetorin e lindjes, qyteti i Gjakovës e nderoi me “Medaljen e mirënjohjes”. Ka marrë dhe dekoratën e lartë “Nderi i Kombit” nga presidenti i Republikës së Shqipërisë. (Vasil S. Tole)

MULA Ismet (1921-1973). Gazetar, politolog. Lindi në Gjakovë. Shkollën fillore e kreu

në vendlindje, ndërsa të mesmen në Shkodër. Studioi shkencat politike në Beograd. Ishte pjesëmarrës i LNÇ-së dhe pas saj ushtroi funksione politike në Prizren e Bujanoc. Në periudhën 1953-1963 ishte drejtor i Radio Prishtinës. Gjatë këtyre viteve Radio Prishtina bëri përparime në profesionalizim dhe në zgjerimin e veprimtarisë: u themelua orkestra e radios dhe u ngrit një plejadë e tërë muzikantësh-instrumentistësh dhe këngëtarësh. Pas vitit 1963, një kohë ishte sekretar për Arsim, Kulturë e Shkencë në Këshillin Ekzekutiv të Kosovës. Gjatë kësaj periudhe dha kontribut në themelimin e institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë. (Zenun Çelaj).

MULA-DOMI Zyhra (1920-1994). Këngëtare. Lindi në Gjakovë. Më 1931 familja e saj u vendos në Shkodër, më pas në Tiranë. Më 1941 u kthye në Kosovë dhe u punësua në Postën e Prizrenit. Aty filloi të këndojë në Radio-Prizrenin e atëhershëm, siç bëhej në rrethanat e asaj kohe. Më vonë kaloi në Prishtinë, ku vazhdon të këndojë në radio dhe të incizojë këngë. Për shkak të rrethanave të kohës nuk pati mundësi t'i incizonte gjithë këngët që i këndonte, prandaj shumica e tyre nuk janë më. (Zeqirja Ballata)

MULAKU Latif (1931-). Gjuhëtar, albanolog, profesor. Lindi në Vushtrri. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, të mesmen në Mitrovicë, ndërsa studimet në Beograd në degën e albanologjisë (1957). Tezën e doktoratës për të folmen e Shalës së Bajgorës e mbrojti në Prishtinë (1965). Më 1960 nisi punën në Fakultetin Filozofik të Prishtinës, si asistent, e më vonë si docent, profesor inordinar dhe profesor ordinar i morfologjisë së sotme shqipe, ku punoi deri në pensionim. Botoi studime e artikuj të ndryshëm për kuptimin e rasave në gjuhën shqipe, sufiksats, drejtshkrimin, për të folmen shqipe të Pesherit etj. Ishte aktiv në komisionin e drejtshkrimit të vitit 1963, mori pjesë në Konsultën Gjuhësore 1968 dhe në Kongresin e Drejtshkrimit më 1972. Me kumtesa shkencore ka marrë pjesë në konferenca dhe tubime të ndryshme të gjuhëtarëve brenda dhe jashtë vendit. Botoi veprat: "E folmja e shqiptarëve të Shalës së Bajgorës" (Govor albanaca Bajgorske Šalje, 1968) dhe tekstin shkollor, "Gramatika e gjuhës shqipe për shkollat e mesme" (1986) etj. Mbahet ndër dialektologët e rëndësishëm të Kosovës. (Agnesa Hasimja)

MULAKU Ragip (1949-). Gjuhëtar, albanolog. Lindi në fshatin Ceceli të Vushtrrisë. Shkollën e mesme e kreu në Vushtrri, studimet në Prishtinë. Studimet pasuniversitare



RAGIP MULAKU

dhe doktoratën i kreu gjithashtu në Prishtinë (1997). Në vitin 1975 u pranua asistent në Institutin Albanologjik të Prishtinës (IAP), ku punoi deri në pensionim. Ishte anëtar i redaksive të revistave "Gjurmime albanologjike" (seria e shkencave filologjike) dhe "Gjuha shqipe". Gjatë viteve 2008-2014 ishte shef i degës së gjuhësisë në IAP. Interesat e tij studimore përfshijnë dialektologjinë, onomastikën, leksikologjinë, kulturën e gjuhës, por interes kryesor e ka studimin e autorëve të vjetër. Mori pjesë në ekspedita studimore në terren për vjeljen e materialit dialektologjik dhe leksikografik. Është autor i veprave "E folmja shqipe e rrethinave të Vuçitërnës" (1982), "Sistemi foljor në gjuhën e shkrimtarëve të vjetër veriorë" (1987), "Parashtesat dhe prapashtesat e gjuhës shqipe në shkrime të vjetra (shek.XV-XVIII)" (1998), "Studime dialektologjike dhe onomastike" (2005), "Gjuha shqipe e shkrimeve të vjetra (shek. XVI-XVIII)" (2012). (Naim Berisha)

MULLA Afërdita (1949-). Pedagogje, mësimdhënëse universiteti. Lindi në Mitrovicë, ku kreu shkollën fillore dhe të mesme, studioi për pedagogji në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Studimet pasuniversitare i filloi në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Sarajevës dhe i përfundoi në departamentin e pedagogjisë të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës, ku në vitin 2006 mbrojti tezën e disertacionit. A. Mulla u shqua me aktivitetin e saj në fushën e edukimit parashkollor: ishte zëvendës drejtore në shkollën fillore "Faik Konica" në Prishtinë, këshilltare për edukimin parashkollor në Entin Pedagogjik të Kosovës si dhe menaxhere e institucioneve parashkollore në komunën e Prishtinës. Në vitin 2006 u zgjodh mësimdhënëse në programin parashkollor të Fakultetit të Edukimit në Prishtinë. Është bashkautore e "Standardeve" (2005) dhe e "Kurikulës" (2006) së edukimit parashkollor në Kosovë (3-6 vjeç), si dhe autore e disa

punimeve profesionale nga fusha e pedagogjisë parashkolllore. (Linda Salihu)

MULLA Gjyldane (1941-). Sociologe, profesoreshe universiteti. Lindi në Pejë, ku kreu shkollën fillore dhe të mesme. Mbaroi studimet për filozofi në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Sarajevës. Kreu studimet pasuniversitare dhe u doktorua në Sarajevë, ndërsa specializimin e mbaroi në Universitetin e Pitsburgut, SHBA. Nisi punë në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës më 1970 dhe vite me radhë ligjëroi lëndë të ndryshme në disa degë të këtij fakulteti (sociologji të përgjithshme, histori shoqërore, pedagogji të përgjithshme, antropologji urbane etj.) deri më 2006, kur u pensionua. Fushë e interesimit studimor të saj ishin sociologjia e përgjithshme, sociologjia urbane, sociologjia e fshatit, zhvillimi i shoqërive bashkëkohore, sociologjia e edukimit etj. Është autore e tekstit universitar “Sociologjia urbane dhe bashkëjetesa qytetare”. (Vjollca Krasniqi)

MULLAABAZI Selajdin (1970-1998). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), dëshmor. Lindi në Rahovec. Që nga fillimi i luftës së armatosur u përfshi në radhët e UÇK-së. Më 12 maj të vitit 1998 mori pjesë në luftimet në betejën e Bardhatinit dhe që atëherë mbante nofkën luftarake “Komandant Mici”. Më 8-9 qershor të vitit 1998 dha kontribut në formimin e shtabit operativ lokal për batalionin e Rahovecit. Me bashkëluftëtarët e tij arriti të zmbrapste forcat serbe në “Luginën e Shqiponjave” në Rahovec më 25 korrik të vitit 1998. Ishte njëri nga bartësit e rezistencës së armatosur të UÇK-së në betejën e Rahovecit. Ra dëshmor në luftimet e 6 nëntorit 1998 në ballafaqim me forcat serbe te Kryqi i Apterushës. (Ali Uka, Valon Brahim)

MULLINJTË E VJETËR (shek. XVIII-XIX). Janë ndërtime të arkitekturës popullore, në funksion të ekonomisë private dhe publike. Gjenden të veçuar, apo në kuadër të komplekseve të vjetra. U shërbenin familjeve, fshatrave, rajonit ose dhe një zone më të gjerë. Janë ndërtuar prej guri të lidhur me gëlqere, apo me trarë, kanë planimetri katërkëndëshe kënddrejtë, çati katërujëse dhe janë të mbuluara me qeramidhe tradicionale apo me listella druri. Në kompleksin e mullirit, përveç

mullirit, hynte edhe depoja për drithëra dhe miell, si dhe kthina e mullisit. Kthina e mullisit kishte oxhakun dhe një dritare të mbuluar me arkitra. Mullinjtë e ndërtuar në afërsi të komplekseve të kullave kishin edhe frëngji pushkësh. Mullinjtë tradicionalë bluanin me ujë, prandaj njihen edhe si mullinj uji. Bluanin me një, dy apo më shumë gurë. Uji që vinte me anë të lugut, me një pjerrtësi prej rreth dyzetepesë shkallësh, binte në rrotat e fletëzuara, duke i vënë ato në lëvizje. Sot numri i këtyre objekteve është i kufizuar dhe rrallë gjendet në funksion ndonjë mulli tradicional, që ruan gjendjen dhe mënyrën fillestare të funksionimit. (Orges Drançolli)

MULLIQI Agron (1961-). Pikturor. Lindi në Gjakovë. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Gjakovë. Vazhdoi studimet për pikturë në Akademinë e Arteve në Prishtinë. Hapi një sërë ekspozitash personale dhe mori pjesë në disa ekspozita kolektive në vend dhe jashtë. Disa nga ekspozitat personale: në CR “Atele”, Prishtinë (1994), në Galerinë e Ministrisë së Kulturës në Prishtinë (2002, 2004), pastaj në Kopenhagë (2004), sërish në Prishtinë më 2005 (“Hani i 2 Robertëve”), në Arhus të Danimarkës (2005), në Ambasadën Amerikanë në Prishtinë (2006), në Galerinë e Arteve të Kosovës (2013) etj. Motivët e pikturave të tij burojnë nga etnografia, miti, legjenda, por edhe nga aktualiteti, globalizimi, deri te një imagjinatë që merr kahe gjeometrike. Disa nga veprat e tij ndodhen në SHBA, Zvicër etj. (Ili Muharremi)

MULLIQI Bahri (1959-). Kompozitor. Lindi në Podujevë. Kreu Shkollën e Mesme të Muzikës në Prishtinë. Përfundoi studimet në drejtimin e pedagogjisë muzikore në Akademinë e Arteve po në Prishtinë. Studioi dhe u diplomua edhe në drejtimin e kompozicionit (1988). Qysh gjatë studimeve u punësua në Korin Profesional të Radiotelevizionit të Prishtinës, më pas u zgjodh asistent në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. U prezantua me sukses në koncerte e festivale në Kosovë, Kroaci, Shqipëri etj. Nga paslufta jeton e vepron në SHBA. Gjatë studimeve dhe më pas ka kompozuar e përpunuar këngë korale (“Insonia”), këngë solo për zë e piano, vepra solistike instrumentale (Variacione për dy piano), kamerale (Trio për vegla me frymë) dhe orkestrale (Diptik simfonik). Ka marrë pjesë

në manifestime muzikore, koncerte e festivale (Ditët e Muzikës Kosovare, Tribuna e krijuesve muzikorë të ish-Jugosllavisë, Ditët e Muzikës Shqiptare në Tiranë etj.). (Zeqirja Ballata)

MULLIQI Demë (1946-). Mësimdhënës, vep-rintar i arsimit, studiues. Lindi në Raushiq të Pejës. Pas shkollës fillore në vendlindje dhe Normales në Pejë, vijoi studimet në Shkollën e Lartë Pedagogjike, përkatësisht në degën e pedagogjisë të Fakultetit Filozofik në Prishtinë. Ishte mësimdhënës, drejtor e pedagog shkolle, këshilltar pedagogjik në Pejë. Në korrik 1998 u caktua koordinator për arsimin e nxënësve kosovarë të vendosur në Mal të Zi, për të vazhduar si ekspert arsimit në Komunën e Pejës. Ishte kryetar i degës së Shoqatës së Pedagogëve për rajonin e Pejës. Prej vitit 2009 u angazhua si mësimdhënës në programin për aftësimin e mësimdhënësve pa shqëputje nga puna. Merret edhe me art pamor. Krahas punimeve profesionale nga fusha e arsimit, D. Mulliqi botoi edhe disa vepra nga fusha e arsimit dhe edukimit: “Skënderbeu edukator i kombit shqiptar” (1995), “Shkollat e mesme të Pejës nën okupim (1990/91-1998/99)” (1999), “Rrugëtimi i shkollës dhe arsimit shqip në komunën e Pejës deri në vitin 1945” (2004), “Shkolla fillore kosovare në Mal të Zi” (2009) etj. (Hajrullah Koliqi)

MULLIQI Gani (1955). Gazetar. Lindi në Sylevicë të komunës së Podujevës. Shkollën fillore dhe gjimnazin i mbaroi në Podujevë, ndërsa studimet për drejtësi i mbaroi në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës (UP), ku kreu edhe studimet pasuniversitare. Si student ishte gazetar-redaktor i revistës së studentëve të UP-së “Bota e re”, pastaj reporter në Televizionin e Prishtinës, ndërsa nga korriku i vitit 1978 fillon punën në gazetën “Rilindja”. Gjatë viteve 1982-1985 ishte korrespondent i “Rilindjes” nga Beogradi, ndërsa gjatë viteve 1992-1996 ishte gazetar dhe redaktor i botimit të “Rilindjes” për perëndim me seli në Zvicër. Në periudhën janar 2000-2009 ishte redaktor i së përditshmes “Zëri”, ndërsa që nga maji i vitit 2009 kaloi me punë në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës. Gjatë viteve 2011-2014 ishte sekretari i parë në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Zagreb (Kroaci), ndërsa nga qershori i vitit 2014 këshilltar për diplomaci publike në Ambasadën e Republikës

së Kosovës në Lubjanë (Slloveni). (Shefqet Rexhepi)

MULLIQI Haqif (1960-). Dramaturg, regjisor, publicist, mësimdhënës universitar. Lindi në Pejë, ku kreu shkollimin fillor, kurse atë të mesëm në Prishtinë. Mbaroi studimet për dra-



HAQIF MULLIQI

maturgji në vitin 2000, në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës, ndërsa në Tiranë mbrojti disertacionin e doktoratës në fushën e shkencave të antropologjisë së dramës dhe të teatrit. Botoi një sërë dramash, të cilat i janë vënë në skenë në teatrot e Kosovës, Shqipërisë, Maqedonisë etj. Në Teatrin Kombëtar të Kosovës janë vënë në skenë tekstet e tij: “Alo 1991”, “Trenat”, “Komedia”, “Ruleti ballkanik”, “Një varr për majorin e mbretit”, kurse në Teatrin e Gjakovës janë dhënë premierë këto tekste të tij dramatike: “Çdo gjë është e mundshme”, “Parfumeria”, “Një varr për majorin e mbretit”, “Gjakova, një luftë ndryshe”, “Kaos atdhedashurie në Paris” etj. Në Teatrin e Qytetit të Prishtinës “Dodona” i janë realizuar tekstet: “Katër epoletat”, “Parfumeria”, “Një përkujtim në kafe teatër”. Ndërkaq, në skenat e teatrove të Tiranës i janë realizuar dramat: “Parfumeria”, “Si e mposhta Musolinin”, “Vejanët”, “Unë, Mirjam dhe Sandri”, “Show Time”. Në vitin 2002 themeloi Teatrin Alternativ “Kosova”, me të cilën inskenoi dramat e tij “The Kosowars”, “Komemorativisht”, “Komedia apo marrëzia njerëzore” dhe “Parfumeria”. Për disa nga tekstet ka bërë vetë regjinë e shfaqjeve. Është pjesëmarrës dhe fitues i çmimeve në disa festivale. Me shfaqjen “Ali Hoxha Hoxhë Alia” fitoi çmimin për tekstin dhe regjinë më të mirë në Festivalin e Teatrove në Mostar (Bosnjë dhe Hercegovinë, 1986), ndërsa me shfaqjen “Kosowars” fitoi çmimin “First of the first” në Edinburgh Fringe (2004), si dhe çmimin për shfaqjen më të mirë në Bienalen e Festivalit European të Teatrove në Braila (Rumani, 2006), ndërsa me shfaqjen “Një përkujtim në kafe teatër” fitoi çmimin si shfaqja më e mirë në Festivalin Ndërkombëtar të Teatrove në Vratza (Bullgari, 2011). Është autor i dhjetëra shkrimeve me karakter diskursiv për dramën, teatrin dhe fenomenet kulturologjike

në përgjithësi. Është mësimdhënës i dramaturgjisë në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. (Besim Rexhaj)

MULLIQI Luan (1953-). Skulptor. Lindi në Gjakovë. Kreu studimet për skulpturë në Akademinë e Arteve Figurative në Prishtinë (1977), ndërsa studimet pasuniversitare në Beograd



LUAN MULLIQI

(1979). Është anëtar i SHAFK-ut nga viti 1977 dhe më pas i disa asociacioneve të artistëve dhe të skulptorëve në SHBA. Mori pjesë në shumë simpoziume të skulpturës me karakter ndërkombëtar dhe botoi një sërë shkrimesh për skulpturë, për artet figurative dhe zhvillimet kulturore në Kosovë. Është autor i dy monografive për artin pamor në Kosovë. Krijimtaria e tij artistike përfshin skulpturën monumentale bashkëkohore dhe atë kombëtare, duke e transformuar në një stil modern. Hapi disa ekspozita personale (Beograd 1979, Çikago 1992, Dallas 1994, Nju-Jork 1995, Prishtinë 2008, Vjenë 2012, Timishoara 2014, Prishtinë 2016 etj.) dhe mori pjesë në shumë ekspozita kolektive jashtë vendit (Shqipëri, Kroaci, Holandë, Kanada, Japoni, Itali, SHBA, Gjermani, Indi, Maqedoni, Francë etj.). Është fitues i disa çmimeve në konkurse të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare: çmimi për skulpturë në Fakultetin e Arteve në Beograd (1978), çmimet “Mosha Pijade” (1979), “40 vjet revolucion” (1981), Bialja e Vizatimit (1983), Salloni Pranveror (1985), shtatorja e “Nënë Terezës” (2000), “Skenderbeu, strateg dhe diplomat” (2004), të gjitha në Prishtinë, pastaj për monumentin e Nënë Terezës në Tiranë (2005), shtatoren e Fehmi Aganit në Prishtinë (2006) etj. Veprat e tij gjenden në disa galeri dhe muze të ndryshëm. Disa prej tyre janë pjesë e koleksioneve private si dhe të personaliteteve të njohura. Për disa vjet ishte ligjërues në Universitetin e Tetovës dhe në Universitetin e Prishtinës. Ishte drejtor i Galerisë Kombëtare të Kosovës, ndërsa nga viti 2012 është anëtar korrespondent në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. (Zeni Balazhi)

MULLIQI Muslim (1934-1998). Piktur, akademik. Lindi në Gjakovë. Kreu shkollën fi-



MUSLIM MULLIQI

llore në vendlindje, nisi Shkollën e Mesme të Artit në Pejë dhe, pa përfunduar vitin e tretë, konkurroi dhe u pranua në Akademinë e Arteve në Beograd, të cilën e kreu më 1959. Po aty më pas kreu studimet pasuniversitare. Në vitin 1963 nisi punën e pedagogut dhe njëkohësisht u zgjodh shef i degës të artit figurativ në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prishtinë. Ishte nismëtar i themelimit të Akademisë së Arteve, e cila nisi punën më 1973. Në vitin 1974 u zgjodh profesor inordinar për vizatim-pikturë dhe u emërua dekan i Akademisë së Arteve. Pas ndërprerjes së procesit mësimor në objektet e fakultetit, mbajti mësim me studentët e tij në studion e vet. Ishte ndër themeluesit e degës së artit muzikor në vitin 1976 në Akademinë e Arteve si dhe të studimeve pasuniversitare. Gjithashtu dha një kontribut për hapjen e Akademisë së Arteve në Universitetin e Tetovës në vitin 1994, ku punoi deri në fund të jetës. Përveç kontributit në institucionet arsimore ishte edhe themelues i Kolonisë Artistike në Deçan, në vitin 1958. Ishte bashkëthemelues dhe kryetar në disa mandate i Shoqatës së Artistëve Figurativë të Kosovës. Në vitin 1979 u zgjodh anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (ASHAK), ndërsa në vitin 1985 anëtar i rregullt. Për dy mandate ishte nënkryetar i ASHAK-ut. Organizoi një sërë ekspozitash personale brenda dhe jashtë vendit. Ekspozitën e parë e hapi në Gjakovë më 1952, pastaj më 1953 në Prishtinë, më 1967 në Beograd, Tuzëll, Pulë, më pas në Novi-Sad (1970), sërish në Beograd më 1974, në Romë 1975, pastaj në Podgoricë (1980), Zagreb (1982), Lubjanë (1984), Tiranë (1993) etj. Mori pjesë në të gjitha ekspozitat kolektive, ku u prezantua piktura dhe arti figurativ i Kosovës. Konsiderohet pionier i artit bashkëkohor të Kosovës. Përfaqësuesi i denjë i ekspresionizmit, nga ciklet e para të kullave të Dukagjinit, te peizazhet urbane të Gjakovës dhe të Pejës e deri te portretet e malësorëve, grave dukagjinase, që janë jo vetëm dëshmi e një kohe, por dhe vepra të një krijuesi të formuar të artit modern, ndër më të spikaturit në artet pamore shqiptare. Veprat e Mulliqit janë të ekspozuara në shumë institucione në Kosovë dhe jashtë saj. Ato janë

dhe pjesë e fondeve të galerive dhe koleksionistëve. Ishte fitues i shumë çmimeve profesionale që në paraqitjet e para, pastaj i mirënjohjeve institucionale dhe publike. Në vitin 2003 Galeria e Arteve e Kosovës themeloi çmimin “Muslim Mulliqi” për arritjet më të suksesshme në fushën e pikturës. (Hivzi Muharremi)

MULLIQI Rexho (1923-1982). Kompozitor, pedagog, udhëheqës koresh, redaktor muzikor. Lindi në Guci të Malit të Zi. Pas shkollës fillore në vendlindje dhe medresesë në Shkup, vazhdoi gjimnazin “Sami Frashëri” në Prishtinë (1941-1944). Studimet e larta për kompozim i ndoqi në Akademinë e Muzikës në Beograd (1948-1953), por pak para diplomimit u burgos dhe për 33 muaj u mbajt në burgun e Goli



REXHO MULLIQI

Otokut (Kroaci). Më 1957 u kthye në Prizren si mësimdhënës në Shkollën e Mesme të Muzikës për lëndët teorike dhe njëherësh u angazhua drejtues i korit të Shoqërisë kulturore-artistike “Agimi”. Një kohë të gjatë ka punuar në redaksinë e muzikës në Radio Prishtinë, por edhe drejtues i korit të saj. Më pas ishte kompozitor i lirë. Në krijimtarinë e tij gjejmë pothuaj të gjitha format muzikore, përveç operës. Është ndër themeluesit e muzikës artistike në Kosovë. Në shumicën e veprave të tij vërehet inspirimi i drejtpërdrejtë nga folklori ynë. Një vend me rëndësi te ky kompozitor zënë, përveç të tjerave, një mori përpunimesh dhe stilizimesh vokale-instrumentale, siç janë ato për zë solo e orkestër, përkatësisht për zë solo, kor dhe orkestër: “Lulëzoi fusha, lulëzoi mali”, “Nji lule që m’ka çelë tash” dhe shumë të tjera. Pastaj veprat e tjera vokale-instrumentale, ku bëjnë pjesë kantata “Poema për ata”, për recitues, soprano, kor e orkestër, frymëzuar nga vargjet e poetit F. Gunga (1961), si dhe “Baresha” për soprano dhe orkestër, e kompozuar mbi vargjet e R. Kukajt. Me rëndësi të veçantë është Simfonia e 2-të “Kosovare” (1971). Nga veprat e tjera orkestrale do të veçojmë: “Fantasia” (1954), Simfonia nr. 1 e pambaruar (1955), “Pastorale” dhe “Valle” (1956), “Akuarelet e Prizrenit” (1958), Suita simfonike, Suitë për piano e orkestër. Ndër veprat muzikore-skenike shquhen baletet “Nita”, i papërfunduar

(1975) dhe “Legjenda mbi ngadhënjimin”. Ndër këngët korale për kor të përzier veçojmë: “Nji lule” (1957), “Vjeshta” (1958), “Vendi im” (1958), ndërsa në veprat solistiko-kamerale bëjnë pjesë: “Elegjia” për violonçel e piano (1955), kushtuar poetit E. Mekuli dhe “Legjenda” për violinë e piano (1956). Për krijimtarinë dhe aktivitetet e tij muzikore është nderuar me shumë çmime dhe mirënjohje. (Rreze Kryeziu-Breznica)

MULLIQI Visar (1966-). Pikturor. Lindi në Prishtinë. Kreu studimet për pikturë në Akademinë e Arteve në Prishtinë (1990). Hapi disa ekspozita personale, ndër të cilat: Cafe Gallery “Roma” (Prishtinë, 1995), Galeria “Dodona” (Prishtinë, 1997), Galeria “Leechgasse” (Grac, 1998), Cafe galeria “Hani i 2 Robertëve” (Prishtinë, 1998), Galeria “Leechgasse” (Grac, 1999), Galeria e Pallatit të Rinisë (Prishtinë, 2001), Galeria “Vizion +” (Gjakovë, 2002), Muzeu i Kosovës (Prishtinë, 2011) etj. Nga viti 1992 mori pjesë në disa ekspozita kolektive të organizuara nga Shoqata e Artistëve Figurativë të Kosovës. Mori pjesë edhe në ekspozitën kolektive “Stop dhunës” e hapur në Muzeun e Vjenës më 1999. Ishte pjesëmarrës në ekspozitën vjetore “Onufri” në Tiranë dhe në disa ekspozita kolektive në vende të ndryshme, si në Japoni, Belgjikë, Gjermani dhe Zvicër. Është mësimdhënës i lëndës së pikturës në Fakultetin e Arteve. (Ilir Muharremi)

MULLIQI Zymer (1995-). Pikturor. Lindi në Raushiq të Pejës. Shkollën fillore dhe Shkollën e Mesme të Artit i kreu në Pejë, ndërsa studimet për dizajn grafik në Akademinë e Arteve në Prishtinë (1980). Është pikturor ekspresiv, abstrakt, i njohur si krijues i peizazheve me motive dukagjinase dhe me ato të arkitekturës së kullave shqiptare. Është anëtar aktiv i Shoqatës së Artistëve Figurativë të Kosovës. Organizoi disa ekspozita individuale dhe mori pjesë në një sërë ekspozitash kolektive në Kosovë dhe jashtë. Për punën e tij mori disa mirënjohje dhe çmime. (Hajrush Fazliu)

MULLIRI I HAXHI ZEKËS (shek. XIX). Në qytetin e Pejës gjendet i ruajtur pjesërisht kompleksi i Mullirit të Haxhi Zekës, i ndërtuar në shekullin XIX. Donator i këtij ndërtimi publik ishte ideatori dhe prijësi i Lidhjes së Pejës, Haxhi Zeka. Arkitektura e objektit paraqet një



MULLIRI I HAXHI ZEKËS NË PEJË

eklektizëm të elementeve perëndimore, lindore dhe lokale, ndërsa teknologjia e funksionimit të mullirit ishte moderne për kohën kur u ndërtua. Përveç mullirit, kompleksi kishte depon e miellit, depon e drithit, ahurin e kuajve dhe një kullë tretatëshe, e cila shërbente si konak për nevojtarët që vinin nga viset e largëta. Kompleksi paraqet një tërësi urbane dhe një ansambël industrial. Në fillim mulliri funksiononte me ujë, kurse më pas me energji elektrike. Me kohë kompleksi ka humbur shumë elemente origjinale të gjendjes fillestare. Sipas fletës kadastrale të vitit 1934, kompleksi kishte një sipërfaqe prej 45 ari, ndërsa sot nga kjo hapësirë kanë ngelur vetëm 10 ari. Nga kompleksi kanë mbetur mulliri, depoja e miellit dhe kulla e adaptuar. Shkatërrimin e fundit mulliri e përjetoi nga ndërmarrja serbo-malaziasë “Bratso” në vitin 1998. Pas restaurimit të objekteve të mbetura, kompleksi në një masë është kthyer në gjendjen e parë. (Fejz Drançolli)

MUMXHIU Ahmet (1927-1999). Mësimdhënës, veprimtar i arsimit. Lindi në Prishtinë, ku kreu shkollën fillore dhe të mesme. Shkollën e Lartë Pedagogjike (SHLP) e kreu në Beograd,



AHMET MUMXHIU

pastaj studimet për matematikë në Fakultetin Filozofik të Prishtinës. Punën mësimore e filloi në vitin 1945, fillimisht mësues në Gjilan, pastaj mësimdhënës në progjimmazin e Mitrovicës, në gjimnazin e Prizrenit dhe në Shkollën Normale të Prishtinës. Vite me radhë ishte mësimdhënës i lëndëve të matematikës në

pastaj studimet për matematikë në Fakultetin Filozofik të Prishtinës. Punën mësimore e filloi në vitin 1945, fillimisht mësues në Gjilan, pastaj mësimdhënës në progjimmazin e Mitrovicës, në gjimnazin e Prizrenit dhe në

SHLP në Prishtinë, ku mori titullin e profesorit të shkollës së lartë. Ishte inspektor i shkollave të mesme në Kosovë, kryetar i Bashkësisë së Shkollave të Larta dhe prorektor i Universitetit të Prishtinës. Publikoi artikuj dhe punime nga fusha profesionale dhe e arsimit. Është autor tekstesh shkollore, sidomos të matematikës për shkollat fillore, të cilat u ribotuan dhe u përdoren në Kosovë disa vjet me radhë, si dhe bashkautor i “Fjalorit terminologjik të shqipës”. Për kontributin e dhënë në fushën e arsimit mori çmime dhe mirënjohje. (Afërdita Deva-Zuna)

MUMXHIU Samedin (1938-2011). Poet, prozator, publicist. Lindi në Pejë. Arsimin fillor dhe të mesëm i kreu në qytetin e lindjes, studimet i vazhdoi në degën e gjuhës dhe të letërsisë shqipe të Fakultetit Filozofik të Prishtinës. Punoi si mësues në komunën e Ferizajt dhe të Istogut. Më pas vazhdoi punën si gazetar i Radio Prishtinës dhe redaktor në Televizionin e Prishtinës. Në fillim shkroi poezi dhe i botoi në revistën “Jeta e re”. Më vonë iu përkushtua prozës tregimtare dhe nga kjo fushë e krijimtarisë botoi veprat: “Ai dhe koha” (1964), “Kundruall orkidesë” (1967) dhe “Njeriu që neveritet” (1972). Përmbledhjet e tij me tregime u ribotuan disa herë. Herë pas here botoi edhe vështrime kritike për autorë dhe për vepra të ndryshme të letërsisë shqipe, të cilat i botoi në gazetatat dhe në revistat shqip të Kosovës. Së bashku me Anton Pashkun botoi shkrimin “Të rijt, letërsia dhe arti”. Konsiderohet njëri nga fillestarët e tregimit modern në letërsinë e Kosovës. (Isak Shema)

MUNDJA. Federata e Mundjes e Kosovës u themelua në dhjetor të vitit 1978 në Prishtinë, kur në Kosovë erdhi trajneri i njohur Muntas Allajbegu në postin e trajnerit të klubit të mundjes “Prishtina”. Nën udhëheqjen e tij “Prishtina” u bë kampione e Jugosllavisë. Me punën e tij ai ngriti shumë mundës përmasash botërore, si: Mustafë Sylja (kampion botëror i vitit 1985 në Clermon-Ferant të Francës), Veton Asllani (nënkampion botëror-1985), Sefedin Krasniqi (medalja e bronzit në po këtë botëror- 1985). Mustafë Sylja në Europeanin e të rinjve më 1997 në Bursa të Turqisë fitoi medaljen e artë. Në Botërorin e vitit 1991 për kadetë në Quebec të Kanadasë, Sadik Ferati fitoi medaljen e artë në stil të lirë dhe të bronzit

në stilin greko-romak. Në po këtë shfaqje Agron Sulaj fitoi medaljen e argjendtë. Këshilli Drejtues i Federatës Botërore të Mundjes në sesionin e 17 janarit të vitit 2015 pranoi Federatën e Mundjes së Kosovës, duke e njohur ndërkombëtarisht. (Xhavit Kajtazi)

MUNICIPIUM DD. Vendbanim i periudhës romake, i njohur dhe si municipium DD (Dardanorum). Ndodhet në fshatin Soçanicë, rreth 27 km në veri të Mitrovicës. I themeluar



MUNICIPUM DD NË SOÇANICË

nga fundi i shek. I mbi bazat e një vendbanimi me të hershëm dardan. Falë minierave të pasura me ar dhe argjend që e rrethonin, municipiumi DD u shndërrua në njërin ndër qendrat me të rëndësishme ekonomike në Dardani për romakët. U ngrit në rang municipal gjatë sundimit të perandorit Hadrian (117-138). Gërmimet e realizuara (1956-1965), të përqendruara në pjesën lindore të vendbanimit, nxorën në dritë forumin, horrea, bazilika urbana, pjesë të termave, në tempullin e Antinoit dhe nekropolin verior. Paraqiste një qytet tipik të urbanizuar romak dhe kishte një shtrirje prej 30 h. Kriza ekonomike që përfshiu Perandorinë Romake dhe, në veçanti, goditja që iu dha veprimtarisë xehetare, ishte shkaktari kryesor që ndikoi në braktisjen e qytetit në gjysmën e dytë të shek. IV. E evidentoi Artur J. Evans dhe u hulumtua nga Muzeu i Kosovës. (Arben Hajdari)

MUNISHI Rexhep (1946-). Etnomuzikolog, profesor universiteti. Lindi në Gmicë të Kamenicës. Shkollën fillore e kreu në fshatin Hogosht të kësaj komune, Shkollën e Mesme



REXHEP MUNISHI

të Muzikës në Prizren. Kreu studimet universitare, fillimisht në teorinë e muzikës, më pas në etnomuzikologji në Akademinë e Muzikës në Beograd (1971). Nga viti 1976 do të qëndrojë disa herë në Paris për specializime tek etnomuzikologët Cl. M. Dubois, G. Rouget e B. Lortat-Jacob. Pas mbarimit të specializimit paraqiti tezën e doktoratës nën mbikëqyrje të prof. D. Charles-it, të cilën e mbrojti më 1981 në Universitetin VIII të Parisit. Nga viti 1971 nisi punë në Institutin Albanologjik të Prishtinës, sektori i etnomuzikologjisë, si këshilltar shkencor deri në pensionim. R. Munishi ka qenë dhe profesor në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës, ku ligjëronte etnomuzikologjinë (1982-2015). Merret me hulumtimin, mbledhjen, incizimin dhe studimin e muzikës popullore tradicionale shqiptare. Krahas teksteve dhe artikujve të botuar në revista profesionale e shkencore në gjuhë të ndryshme, ka botuar deri më tani këto vepra: “Këndimi i femrave të Podgurit” (1979), “Këngët malsorçe shqiptare” (1987), “Krijimtaria korale shqipe në Jugosllavi” (1988), “Probleme etnomuzikologjike” (1997), “Identiteti muzikor” (2001). Është pjesëmarrës në kongrese, sesione e tribuna të ndryshme brenda dhe jashtë vendit. Për rezultatet hulumtuese etnomuzikologjike ka marrë disa çmime, ndër të cilat janë: Shpërblimi i Dhjetorit (1987), dy herë çmimin vjetor të Shoqatës së Kompozitorëve të Kosovës (për veprën “Këngët malësorçe shqiptare” dhe “Krijimtaria korale shqipe në Jugosllavi”). (Rreze Kryeziu-Breznica)

MUNISHI Shkumbin (1971-). Gjuhëtar, albanolog, profesor universiteti. Lindi në Prishtinë, ku kreu shkollimin fillor dhe të mesëm. Studimet për gjuhë shqipe i përfundoi më 1996 në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës (UP), ku më pas kreu studimet pauniversitare dhe mbrojti tezën e disertacionit të doktoratës (2006). Në fillim punoi si gazetar e më pas përkthyes dhe bashkëpunëtor në projekte ndërkombëtare në fushën e politikave

ekonomike. Nga viti 2003 punon në degën e gjuhës shqipe të Fakultetit të Filologjisë të UP-së, në fillim si asistent, më pas profesor asistent dhe profesor i asociuar (2012). Është specialist i sociolinguistikës, i planifikimit të gjuhëve, i standardologjisë dhe i kontakteve të gjuhëve, fusha në të cilat botoi disa libra: “Probleme të shqipes standarde në Kosovë” (2013), “Pikëpamjet e Androkli Kostallarit për shqipen standarde” (2013), “Shqipja në epokën e globalizimit” (2015). Është i pranishëm me studime në këto fusha në qarqet shkencore brenda dhe jashtë vendit. Është kryeredaktor i revistës “Filologji” dhe anëtar i Këshillit Ndërkademiç për Gjuhën Shqipe. (Bardh Rugova)

MUNISHI Zijadin (1941-2008). Gjuhëtar, albanolog. Lindi në Gmicë të Kamenicës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, normalen në Prishtinë, ku më pas përfundoi studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe. Studimet pasuniversitare në fushën e gjuhësisë i kreu më 1979. Ishte ligjërues në Shkollën e Lartë Pedagogjike “Skënderbeu” në Gjilan. Në vitin 1988 kalon ligjërues në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prishtinë. Më pas, për dy mandate ishte drejtor i saj. Pas masave të dhunshme në Universitetin e Prishtinës, u angazhua për vazhdimin e punës së këtij universiteti në objekte private. Më 1999 ishte ndër nismëtarët e themelimit të Fakultetit të Edukimit, në të cilin ishte anëtar i bordit drejtues dhe ligjërues. Botoi disa libra e studime, si: “Gjuha shqipe e kultura e të shprehurit” (1984), “Zgjedhimi i foljeve në gjuhën standarde shqipe” (1998), “E folmja e Gollakut të Kamenicës”, “Mbi tipat dhe mbi disa veçori të strukturës leksiko-gramatikore të mikrotoponimeve të katundit Gmicë të Gollakut”, “Për disa kritere dhe metoda më shkencore të mbledhjes dhe të botimit të leksikut popullor”, “Përdorimi i drejtë i nyjave të përparme”, “Kultura e gjuhës dhe kultura e të folurit”, “Roli dhe rëndësia e dialektologjisë në mësimin e gjuhës amtare”, “Si ta krijojmë sistemin arsimor universitar gjithëkombëtar” etj. (Shpëtim Elezi)

MUQEZIU Hafiz Jakup (1919-2006). Titullar i fesë islame, i burgosur politik. Lindi në Prizren më 1919, ku kreu shkollën fillore dhe vazhdoi mësimet për disa vjet në Medresenë e Gazi Mehmed pashës po në Prizren. Punoi për

disa vjet si myezin dhe imam. Në vitin 1946 u angazhua për hapjen e zyrës së Bashkësisë Islame të qytetit dhe aktivizoi topin në Kalanë e Prizrenit, si njoftim për fillimin e iftarit për ramazan. Po në ato vite u përfshi në Lëvizjen Nacional Demokratike Shqiptare (NDSH), që bëri të arrestohej më 1950 dhe të dënohej me vdekje. Vuajti 12 vjet heqje lirie në burgun e Nishit. Pas daljes nga burgu, hapi një dyqan xhamaprerësi dhe pas një kohe u aktivizua si imam në Xhaminë e Emin Pashës në Prizren. Pas luftës së vitit 1999 ishte aktiv në tubimet e veteranëve të NDSH-së dhe të Ballit Kombëtar. (Nexhat Ibrahim)

MURADI Ferid (1936-). Mjek, klinicist, farmakolog, fitues i Çmimit Nobel për mjekësi (1998). Lindi në qytetin Whiting, Indiana, SHBA, nga i ati me origjinë nga Gostivari



FERID MURADI

dhe e ëma amerikane. Kreu Kolegjin në Universitetin De Pauw në Greencastle (Indiana) për shkencat shoqërore (1954-1958), por njëkohësisht studioi edhe për anatomi, embriologji, biologji e kimi. Më pas studioi mjekësinë në Universitetin “Washington” në Sent-Luis dhe programin e doktoratës në Universitetin “Western Reserve”, School of Medicine, në departamentin e farmakologjisë, Klivlend, Ohaio. U përfshi në studimet e Earl Sutherland dhe Theodore Rall (zbuluesit e AMP-ciklike). Pasi kreu stazhin, filloi kërkimet në Institutin e Kardiologjisë. U ftua nga Universiteti i Virxhinias për të ngritur një sektor të ri të farmakologjisë klinike në departamentin e mjekësisë. Ishte drejtor i qendrës për hulumtime klinike (1971), drejtor i departamentit të farmakologjisë klinike në Universitetin e Virxhinias (1973), ku filloi dhe eksperimentet e para për hulumtimin e efekteve biologjike të oksidit nitrik. Kishte një varg funksionesh drejtuese në institucione të njohura të mjekësisë klinike dhe eksperimentale, pa i ndërprerë asnjëherë hulumtimet. Prej vitit 1975 deri më 1981 ishte profesor në departamentin e mjekësisë interne dhe të farmakologjisë në Universitetin e Virxhinias, në periudhën 1971-1981 drejtor i Qendrës për Kërkime Shkencore po në këtë universitet, profesor në departamentin e mjekësisë interne dhe

të farmakologjisë në Universitetin e Stanfordit (1981-1989), më pas profesor i farmakologjisë në Çikago dhe zëvendëspresident për studime dhe zhvillime farmaceutike dhe oficer i korporatës “Abbott Park”, Illinois (1993-1995). Nga viti 1997 ishte përgjegjës i departamentit të biologjisë dhe farmakologjisë në Universitetin “Texas” të Hjustonit dhe drejtues i Institutit të Mjekësisë Molekulare nga viti 1999. Është anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe i Shoqatës së Mjekëve, Stomatologëve dhe Farmacistëve Shqiptarë të Maqedonisë, anëtar i Akademisë Amerikane të Arteve dhe të Shkencave (2000). Është bartës i shumë mirënjohjeve dhe dekoratave. Jeton në Uashington, SHBA. (Isuf Dedushaj)

MURATI Jahi (1940-). Gjeograf. Lindi në fshatin Stanec të Karadakut të Preshevës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje dhe në Caravajkë, normalen në Prishtinë (1962) dhe diplomoi në departamentin e gjeografisë të Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore në Shkup (1966). Studimet pasuniversitare i mbaroi në Zagreb, ndërsa studimet e doktoratës i përfundoi në Shkup, në fushën e gjeomorfologjisë me disertacionin: “Relievi i ujëmbledhësit të Moravës së Binçës”. Në fillim të karrierës punoi si mësues në fshatrat Kurbali e Stanec, më pas, deri në pensionim, punoi si profesor i gjeografisë në gjimnazin dhe shkollën e mesme teknike të Preshevës. Për shumë vjet ishte bashkëpunëtor i jashtëm në Entin Pedagogjik Rajonal. Ka botuar disa vepra profesionale dhe shkencore, si: “Fjalori i gjeomorfologjisë”, “Legjendat e Karadakut”, “Kështjella e Preshevës” etj. (Arsim Ejupi)

MURATI Nagip (1953-). Inxhinier i metalurgjisë, profesor universiteti. Lindi në Gjilan, shkollën fillore dhe të mesme i mbaroi në Prishtinë, studimet e rregullta dhe pasuniversitare i kreu në Fakultetin e Teknologjisë dhe të Metalurgjisë të Universitetit të Beogradit. Tezën e doktoratës e mbrojti në Universitetin Politeknik të Tiranës (1995). Punoi në Kombinatin xehetar-energjetik “Kosova” të Obiliqit dhe më pas në ndërtimin e “Ferronikelit” në Drenas. U zgjodh asistent në Fakultetin e Xehetarisë dhe të Metalurgjisë në Mitrovicë (1997), më pas mori titullin ligjërues dhe profesor ordinar



NAGIP MURATI

punimesh profesionale-shkencore dhe mori pjesë në disa konferenca shkencore brenda dhe jashtë vendit. (Shyqeri Kelmendi)

MURATI Osman Sefer (1897-1979). Rapsod popullor, i njohur me emrin Sefer Beçuku. Lindi në fshatin Beçuk të Artakollit (Vushtri). Filloi të këndojë që në moshën 18-vjeçare. Përvojën e parë folklorike e fitoi nga rapsodi Hysen Zhilivoda, i cili ishte i njohur si mjeshtër i këngës epike në trevën e Artakollit dhe në vise të tjera të Kosovës. Këndoi edhe me rapsodët Avdi Hyseni, Mehë Zeqiri etj. Këngën e shoqëronte me veglat muzikore që u binte me mjeshtri: lahutë, çifteli, sharki. Më shumë këndonte këngë kreshnike të ciklit të Mujit dhe Halilit, pastaj këngët historike për Oso Kukën, Miftar Hasanin, këngët për Demë Ahmetin, për Arif Sinanin, për Ahmet Delinë etj. Duke qenë pjesëmarrës i shumë luftërave që ndodhën gjatë jetës së tij në Kosovë, krijoi dhe u këndoi shumë këngë bashkëluftëtarëve të tij. Njihte më shumë se 90 këngë rapsodike, të cilat i këndonte në dasma dhe në ahengje të ndryshme. (Krenar Doli)

MURATI Qemal (1955-). Gjuhëtar, albanolog, profesor universiteti. Lindi në Tuhin të Kërçovës, ku kreu shkollimin fillor, ndërsa gjimnazin dhe studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe i kreu në Prishtinë. Më pas kreu studimet pasuniversitare dhe u doktorua më 1989 rreth sllavizmave në të folmet shqipe të Maqedonisë. Më 1982 zë punë në Institutin Albanologjik të Prishtinës dhe më pas në Fakultetin e



QEMAL MURATI

Filologjisë të Universitetit të Tetovës. Më 1999 u zgjodh profesor i rregullt në Universitetin e Tetovës. Është anëtar i Institutit të Trashëgimisë

Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, drejtuesi i Seminarit Ndërkombëtar për Albanologji në Tetovë (2007-2010), kryeredaktor i revistës “Studime albanologjike” të Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup etj. Botoi një sërë librash kryesisht rreth normës së shqipes dhe të kontakteve të shqipes me gjuhët sllave: “Elementet e shqipes në gjuhët sllave jugore” (1990), “Konservacione dhe inovacione gjuhësore në fushë të shqipes” (1991), “Drejtëpërdorimi i shqipes dhe kultura gjuhësore” (1996), “Fjalor i shqipes truallsore të Maqedonisë” (1998), “Fjalor i fjalëve të rralla të përdorura në viset shqiptare të Maqedonisë” (2003), “Fjalor idiomatik shqip-maqedonisht” (2003), “Standardi gjuhësor dhe kultura e shprehjes” (2004), “Bashkëmarrëdhëniet gjuhësore shqiptare-maqedonase” (2007), “Gjuha e medieeve” (2008), “Kërçova - Hulumtime linguistike, etnografike dhe folklorike” (2008), “Për shqipen standarde” (2009), “Gjuha shqipe në komunikimet publike” (2013). Gjithashtu është bashkautor i fjalorit të fjalëve të huaja (1988) dhe i fjalorit serbisht-shqip (2013) etj. (Naim Berisha)

MURATI Rexhep (1950-). Jurist, profesor universitar. Lindi në Hajkobillë, komuna e Prishtinës. Diplomoi në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës (UP), magjistroi në Fakultetin Juridik të Universitetit të Beogradit dhe doktoroi në Fakultetin Juridik të Universitetit të Sarajevës (2006). Në vitin 1977 filloi punën në Fakultetin Juridik të UP-së si asistent, duke arritur deri te titulli profesor i rregullt. Ishte kryeredaktor i revistës “E drejta”, anëtar i Komisionit Këshillëdhënës Gjyqësor për emërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, anëtar i Këshillit Programor të Institutit Gjyqësor të Kosovës, anëtar i Këshillit drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës etj. Kreu edhe një sërë detyrash në institucionet e arsimit të lartë. Publikoi shumë punime shkencore brenda dhe jashtë vendit. Mori pjesë në konferenca shkencore, tryeza dhe simpoziume. Është autor dhe bashkautor i teksteve universitare dhe i një monografie (“E drejta e procedurës penale”, “Rishikimi i procedurës penale për shkak të fakteve dhe provave të reja”, “Sistemi i procedurës penale në Kosovë”). (Blerim Reka)

MURATI Skender (1967-). Mjek, kirurg, drejtues i shërbimeve shëndetësore në Llap gjatë

luftës së Ushtrisë për Çlirimin e Kosovës (UÇK). Lindi në fshatin Llapashticë të komunës së Podujevës. Kreu studimet në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës, ndërsa specializimin për kirurgji të përgjithshme e përfundoi në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës në Prishtinë. Në vitin 1988 u arrestua dhe u dënua me një vit burg për aktivitet politik. Profesionin e mjekut e ushtroi në spitalin “Isa Grezda” në Gjakovë dhe në ambulancën shëndetësore “Nënë Tereza” në Podujevë. Në vitin 1998 u emërua shef i sektorit të shërbimeve shëndetësore në Zonën Operative të Llapit. Pas luftës u angazhua në detyra të ndryshme të menaxhimit dhe drejtimit të institucioneve shëndetësore në Podujevë dhe në Prishtinë. (Ismet Cakiqi)

MURATI Valon (1975-). Veprihtar politik, pjesëmarrës i luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Lindi në Prishtinë. Shkollën fillore dhe të mesme, si dhe studimet i mbaroi në Prishtinë, ndërsa studimet pasuniversitare në Universitetin e Sarajevës dhe të Bolonjës. Aktivitetin politik e filloi që nga viti 1993 si anëtar i Lëvizjes Kombëtare për Çlirimin e Kosovës (LKÇK). Nga viti 1995 ishte anëtar i redaksisë së gazetës së LKÇK-së “Çlirimi”, ndërsa nga vitet 1998-1999 (pas rënies së Bahri Fazliut) ishte kryeredaktor i kësaj gazete. Gjatë fushatës së arrestimeve të anëtarëve të LKÇK-së dhe UÇK-së, në janar dhe shkurt të vitit 1997 u detyrua të largohet në Tiranë. Një vit më pas u kthye në Kosovë dhe u përfshi në strukturat e UÇK-së. Veproi në disa zona të luftës. Së fundi, në Zonën Operative të Llapit udhëhoqi sektorin për moral dhe politikë. Pas luftës vazhdoi aktivitetin politik në kuadër të LKÇK-së dhe në Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës (AAK). Në vitin 2007 ishte ndër nismëtarët e themelimit të Lëvizjes për Bashkim, ndërsa nga nëntori i vitit 2015 u bë kryetar i saj. Në dhjetor të vitit 2014 u emërua ministër i Diasporës në Qeverinë e Kosovës. (Ilijer Ulaj)

MURATI Xheladin (1942-). Pedagog, profesor universiteti. Lindi në Xhepcisht të Tetovës. Kreu shkollën normale dhe studimet për pedagogji në Shkup, ndërsa studimet pasuniversitare i kreu në Fakultetin Filozofik në Beograd (1978). Disertacionin e doktoratës nga shkencat pedagogjike e mbrojti në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës (1984). Ishte

mësimdhënës në gjimnazin e Tetovës, pastaj profesor në Akademinë Pedagogjike në Shkup dhe drejtor i Entit Pedagogjik në Tetovë, si dhe mësimdhënës në Fakultetin Filozofik, përkatësisht në Fakultetin Pedagogjik të Shkupit, në Universitetin Shtetëror të Tetovës dhe në Universitetin e Europës Juglindore (UEJL) në Tetovë. Në dy mandate ka qenë deputet në Kuvendin e Maqedonisë dhe nënkryetar i tij. Merret me trajtimin e problemeve teorike dhe praktike të pedagogjisë, didaktikës, metodologjisë së kërkimit dhe komunikologjisë pedagogjike. Botoi shumë punime shkencore e profesionale në revista të ndryshme. Ka marrë pjesë në konferenca, simpoziume dhe tribuna shkencore. Ka botuar disa vepra nga fusha e pedagogjisë dhe didaktikës: “Naim Frashëri - pikëpamjet edukative-arsimore” (1992), “Aspekte të sistemit arsimor në Maqedoni” (1997), “Didaktika”, “Komunikologjia pedagogjike” (2003) etj. (Fadbi Osmani)

MURIQI Ali (1954-). Inxhinier i makinerisë, profesor universiteti. Lindi në Nabërgjan të Pejës. Shkollimin fillor dhe të mesëm i kreu në Pejë, studimet në Fakultetin Teknik të Univer-



ALI MURIQI

sitetit të Prishtinës (UP). Studimet pasuniversitare i kreu në Universitetin e Lubjanës, ndërsa tezën e doktoratës e mbrojti në Fakultetin e Makinerisë të UP-së. Punoi në Fabrikën e Autopjesëve në Pejë, pastaj në “Ferronikël” dhe në

Institutin “Inkos”. Nga viti 1992 kaloi me punë në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike. Është bashkautor i një teksti universitar dhe autor i disa dispensave. Është titullar i disa lëndëve në Fakultetin e Shkencave Teknikë të Aplikuara të Mitrovicës, kurse më pas u përqendrua në lëndën termodinamika, transmetimi i nxehtësisë dhe i masës. Ishte anëtar i Komisionit për zhvillimin e cilësisë në UP (2009-2012), bashkëprofesor në Universitetin Veror të Prishtinës, koordinator i UP-së etj. Nga viti 2012 ishte anëtar i komisionit për certifikimin e auditorëve dhe menaxherëve të Energjisë dhe anëtar i Komitetit Teknik të Kosovës për Standarde. Është autor i disa punimeve profesionale dhe shkencore. (Xhemajl Fejzullahu)

MURIQI Elvir (1979-). Boksier. Lindi në Pejë, pastaj migroi në SHBA në vitin 1996. Muriqi nisi me boks, pastaj pas dy vjetësh kaloi në sportin e kikkoksit. Si kikkoksier pati disa suksese si në Kosovë, ashtu edhe në SHBA. Në vitin 1998 filloi të boksojë si profesionist dhe fitoi disa tituj: “Golden Gloves” në vitin 1998, “NABC World Title” në vitin 2004 në Kosovë dhe “American Title” në vitin 2009 në Karolinën e Veriut. Deri më tani ka zhvilluar 47 meçe si boksier profesionist, prej të cilave ka 40 fitore, 24 me nokaut. (Tahir Sopi)

MURIQI Fadil (1959-). Futbollist, trajner. Lindi në fshatin Zahaç të Pejës. Nisi karrierën në KF “Buduçnosti” (1978/79), asokohe anëtar i ligës së dytë të ish-Jugosllavisë. Pas këtij stinori kalon te KF “Prishtina”, ku luajti plot dhjetë vjet radhazi, përfshirë këtu pesë kampionate në ligën e parë federative të ish-Jugosllavisë, duke qenë njëri nga mesfushorët më të mirë të asaj lige. Pas rënies së “Prishtinës” nga liga e parë (1988/89), së bashku me të vëllanë Xhevdetin, u bë pjesë e skuadrës kroate të futbollit “Rijeka”, që bënte gara në ligën e parë të ish-Jugosllavisë, ku luajti vetëm në edicionin e radhës (1989/90). Më pas shkoi në Australi, ku u angazhua te skuadrat “Croatia” e Sidnejit, pastaj “Canberra”, “Dandenong Thunder”, “Fawkner Blues”, “Dandenong Thunder” dhe “Chelsea Hajduk” deri në vitin 2001. Një vit ishte trajner i skuadrës australiane “Dandenong Thunder”. Pas shumë vitesh të kaluara në Australi u kthye në Kosovë, si trajneri i KF “Prishtina” (2005/06) dhe KF “Drita” të Gjilanit, por pa ndonjë sukses. U kthye sërish në Australi. (Rifat Gjonbalaj)

MURIQI Nebih (1943-). Piktur, poet, kritik arti. Lindi në Portës të Shqipërisë. Kreu skollën fillore në Novosellë të Pejës, Shkollën e Mesme të Artit në Pejë, ndërsa Akademinë e Arteve



NEBIH MURIQI

Aplikative në Beograd (1969), ku kreu edhe studimet pasuniversitare për pikturë monumentale. Në fillim punoi në redaksinë e revistës “Fjala” si redaktor artistik (1972-1974), pastaj në Akademinë e Arteve në Prishtinë mbajti lëndën

nudo si mësimdhënës gjatë viteve 1975-2006. Ishte drejtor i Galerisë së Arteve të Kosovës në

Prishtinë (1988-1992). Si anëtar i Shoqatës së Artistëve Figurativë të Kosovës mori pjesë në ekspozita kolektive brenda dhe jashtë vendit dhe hapi disa ekspozita personale, si në Beograd (1969, 1975), Sombor (1971), Novi-Sad (1974) dhe Prishtinë (1973, 1984, 2010). Vizatimet dhe pikturat e tij i veçon shprehja ekspresive me simbolikë. Ka trajtuar psikologjinë e njeriut në rrethanat e kohës dhe në hapësirën e caktuar. Përveç me pikturë, u mor intensivisht me shkrime kritike dhe eseistike për artet figurative. Nga kjo fushë botoi librin me ese "Baraspesha estetike" (1989). Që herët u mor intensivisht edhe me poezi. Botoi disa përmbledhje poetike: "Në syrin e pranverës" (1965), "Kariatidet" (1973), "Yll në gur" (1979), "Hedhësi i diskut" (1986), "Gjakshkrim" (1996) etj. Për pikturë dhe për poezi mori disa çmime dhe mirënjohje. (Rexhep Goçi)

MURIQI Xhevdet (1962-). Futbollist. Lindi në Zahaq të Pejës. Me futboll nis të merret që në moshë të re, në vitin 1977 angazhohet si futbollist në KF "Kristali" të Pejës, më pas vazhdon karrierën në KF "Prishtina". Në mungesë të përfaqësueses së Kosovës, dhjetë vjet radhazi luajti për përfaqësuesen e të rinjve U-18 të ish-Jugosllavisë. Në KF "Prishtina" luajti në kohën kur ishte në kulmin e karrierës (1980-1988) më pas vazhdoi edhe për dy vite te "Rijeka" e Kroacisë. Në Kroaci i kaloi edhe tetë vjet të tjera, te KF "Shibeniku", më pas te KF "Imotski", ku kreu edhe detyrën e trajnerit. Ndërkaq, në vitin 2003, pas angazhimit në "Imotski", përfundoi karrierën profesionale në NK "Primorac" në Biograd. (Rifat Gjonbalaj)

MURSELI Ilir (1965-). Inxhinier i arkitekturës, mësimdhënës universitar. Lindi në Prishtinë, ku kreu shkollimin fillor dhe të mesëm. Studimet për arkitekturë i kreu në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe të Arkitekturës të Universitetit të Prishtinës (UP) (1991). Në vitin 1997 themeloi studion e vet projektuese. Deri në vitin 2000 u mor me projekte të vogla, kryesisht investime private. Në vitin 2000 themeloi studion projektuese "United Consultants Group (UCG)", e cila deri në vitin 2008 u mor me projekte kapitale në Kosovë. Ndërkohë, në vitin 1992 u angazhua si asistent në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe të Arkitekturës të UP-së dhe më pas ligjërues i lëndës analiza arkitekturale. Bashkëpunoi me

shumë arkitektë vendorë dhe ndërkombëtarë. Ndër të tjera, veçohen projektet për amfiteatrin e Fakultetit Ekonomik, "Parku arkeologjik" i Muzeut të Kosovës, Qendra e Shëndetit Mental në lagjen "Ulpiana", Qendra e Emergjencës Psikiatrike në Qendrën Spitalore Universitare etj. (Dervish Qerreti).

MURSELI Maxhide (1948-). Gazetare. Lindi në Prishtinë. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Prishtinë, ku më pas kreu edhe studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Prishtinës (1980). Prej vitit 1968 punoi gazetare dhe redaktore në gazetën "Rilindja". Ndoqi punën dhe aktivitetin e shoqatave që përfaqësonin gruan, si dhe problematikën sociale dhe arsimore të gruas në shoqërinë kosovare. Në periudhën 2003-2007 punoi në gazetën "Bota sot". Ka botuar shkrime edhe në disa revista të vendit, si: "Kosovarja", "Teuta" dhe "Ora", si dhe në revistat jashtë vendit, si "Dnevnik" (Lubjanë, Slloveni), "Viena Cajtung" (Vjenë, Austri). U mor edhe me përkthime nga gjuha serbe dhe nga gjuha turke. (Hyra Tejeci)

MURTAJA. Është sëmundje tipike e kafshëve, që bartet te njeriu, duke ndjekur ciklin: brejtës - kafshë - pleshti i infektuar (xenopsila cheopis) - njeri. Epidemitë e para janë regjistruar qysh në shek. III para erës së re në Misir dhe Siri. Pandemia e parë që shpërtheu në shek. VI përfshiu të gjitha shtetet e Europës, zgjati më se gjysmë shekulli dhe mori jetën e më se 100 milionë njerëzve. Pandemia e dytë u shfaq në mesjetë, kur vdiqën një e katërta e banorëve të Europës. Me viktima të mëdha kaloi edhe pandemia e shek. XIX. Murtaja, që ishte çdoherë e pranishme në Europë, preku edhe popullatën e Kosovës. Në dhjetëvjetëshin e tretë të shek. XVII sëmundja përfshiu Shkupin, Prizrenin dhe Pejën, me çrast ndodhi vdekja masive e popullatës. Edhe sot mbetet një ndër sëmundjet me shkallë të lartë të rrezikut për jetën e njeriut. Shkaktohet nga bacili Yersenia pestis. Periudha e inkubacionit sillet prej 1 deri në 7 ditë. Janë 3 forma klinike të sëmundjes: lëkurore, mushkërore dhe septike. Nëse trajtimi i sëmundjes nuk fillon brenda ditës me antibiotikë, përfundon me vdekje. Pas kalimit të sëmundjes, kohëzgjatja e imunitetit është e pasigurt dhe e shkurtër. Rreziku i paraqitjes së sëmundjes është zvogëluar në minimum. Zonat enzotike të sëmundjes janë:

SHBA (Bregu Perëndimor), Amerika e Jugut, Afrika dhe Azia Qendrore dhe Juglindore. Në Kosovë nuk ka raste të mortajës ndër kafshë dhe njerëz. Parandalimi dhe kontrolli i sëmundjes bëhet duke asgjësuar kafshët e infektuara dhe me vaksinimin e personave potencialisht të rrezikuar. (Isme Humolli)

MURTEZAI Ekrem (1931-). Filozof, profesor universiteti, akademik. Lindi në Gjakovë, ku kreu shkollën fillore dhe mori mësim në Medresenë e Madhe të Gjakovës. Në vitin



EKREM MURTEZAI

1948 u regjistrua në Shkollën Normale të Gjakovës, ndërsa në vitin 1951 u diplomua në Pejë. Studioi për filozofi në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Beogradit. Pas studimeve deri në fund të viteve '60 punoi mësimdhënës në shkollën normale dhe në gjimnazin e Gjakovës, ku ishte edhe drejtor. Nga viti 1969 e deri në vitin 1973 ishte në detyrën e këshilltarit të pavarur në Byronë Ekzekutive të Komitetit Qendror të Lidhje Komuniste të Jugosllavisë (LKJ) dhe njëkohësisht edhe shef i kabinetit të Fadil Hoxhës, i cili në atë kohë ishte anëtar i Byrosë Ekzekutive. Ndërkohë mbaroi studimet pasuniversitare për politikologji në Fakultetin e Shkencave Politike në Beograd. Në vitin 1973 u zgjodh ligjërues i lëndëve historia e filozofisë antike dhe mesjetare dhe filozofisë marksiste në katedrën filozofi-sociologji në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës (UP), ku më 1977 mbrojti edhe tezën e disertacionit të doktoratës me titull "Lenini për logjikën dialektike". Ishte profesor i rregullt i lëndëve të lartpërmendura gjatë viteve 1983-1991, por edhe i disa lëndëve të tjera filozofike: estetike, logjike, filozofi klasike gjermane, filozofi bashkëkohore etj. Për një kohë ligjëroi edhe metodologjinë dhe teknikat e kërkimeve shkencore në degën e gjuhës dhe të letërsisë shqipe. Gjatë viteve 1973-1981 ishte drejtor i Qendrës Krahinore të Arsimit Marksist. Kreu edhe detyra të tjera në institucionet e arsimit. Anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave dhe i Arteve të Kosovës u zgjodh në vitin 1996, kurse në vitin 2000 u zgjodh anëtar i rregullt. E. Murtezai është autor i disa librave nga fusha e filozofisë, i artikujve shkencorë, i fjalorëve terminologjikë,

i librave shkollorë etj., ndër të cilat veçojmë "Filozofia materialiste-dialektike" (1975), "Studime filozofike" (1975), "Stalinizmi dhe neostalinizmi" (1976), "Pikëpamja e Leninit për metodën dialektike" (1976), Marksizmi, socializmi dhe vetëqeverisja" (1981), "Disa terma aktualë politikë" (1986), "Fjalori i filozofisë" (1995), "Fjalor i feve" (2000), "Hyrje konceptuale në filozofi" (2015) etj. (Albulena Alushaj)

MURTEZANI Izaim (1965-). Studiuues i folklorit dhe i etnologjisë. Lindi në Kopanicë të komunës së Sarajit, në afërsi të Shkupit. Në fshatin e lindjes kreu arsimin fillor, kurse shkollimin e mesëm në gjimnazin "Zef Lush Marku" në Shkup. Po në Shkup kreu edhe studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe, më pas studimet pasuniversitare dhe të doktoraturës. Në vitin 1995 zë punë në Institutin e folklorit "Marko Cepenkov" në Shkup, ku vazhdon të punojë edhe aktualisht. Ka botuar një sërë studimesh nga fusha e folklorit dhe e etnologjisë dhe është autor i disa monografive studimore: "Në shtjellën e arketipave (Studime nga folklori dhe etnologjia)" (2001), "Turqizmat në gjuhën e poezisë popullore shqipe dhe maqedonase" (2001), "Elementet mitike në eposin heroik dhe baladat popullore shqiptare dhe maqedonase" (2006), "Semiologjia e hapësirës mitike (Sipas shembujve të këngëve popullore shqiptare dhe të sllavëve të jugut)" (2010), "Festa e Shëngjergjit të shqiptarët e Maqedonisë" (2010), "Refleksione etnokulturore" (2014) etj. Ka marrë pjesë në shumë tryeza e konferenca shkencore të mbajtura brenda dhe jashtë vendit. (Arbnora Dushi)

MURTEZI Behie (1986-). Balerinë. Lindi në Skënderaj. Kreu degën e baletit në Shkollën e mesme të muzikës "Prekë Jakova" në Prishtinë, ndërsa pedagogjinë në Fakultetin



BEHIE MURTEZI

Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Punon si soliste e parë në Baletin e Kosovës. Lua jti në shumë shfaqje të baletit të realizuara në Teatrin Kombëtar të Kosovës: "Transicion 2", "Dasma arbëreshe", "S'po dëgjohet gongu", "Kontrast", "Kutia e zezë", "Kolazh baleti" "Performancë", "Bukuroshja e fjetur",

“Antidogma”, “Rapsodi mbi temat e Paganinit”, “Carmen”, “Oh, Zoti im”, “Don Kishoti”, “Dasma”, “Aty ku bie drita”, “Liria ime”, “Verdi”, “Kopshiti i shpirtrave” etj. Në Paris bëri koreografinë e shfaqjes “Fryma e re” në Teatrin La Palace (2013) dhe të shfaqjes “Gjashtë persona kërkojnë autorin”, produksion i Teatrit Kombëtar të Kosovës (2014). Me disa shfaqja mori pjesë në festivale ndërkombëtare. (Ragip Sylaj)

MURTEZI Zijadin (1953-). Aktor. Lindi në Opajë të Kumanovës. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje dhe në Kumanovë. Studimet për aktrim i mbaroi në Fakultetin e Artit Dramatik në Shkup (1976). Më 1977 u punësua si aktor i rregullt në Teatrin e Kombësive (Drama Shqipe), përkatësisht në Teatrin Shqiptar të Shkupit. Në këtë teatër luajti role të shumta në shfaqje të ndryshme, nga të cilat veçohen: “Kush e solli Doruntinën”, “Hamleti”, “Policët”, “Dhëndrri nga Parisi”, “Hamdi Beu”, “Bohçja”, “Bregu i pikëllimit”, “Dielli perëndon”, “Mbreti Lir” etj. Përveç në teatër, luajti në role të ndryshme edhe në disa filma artistikë dhe në disa filma televizivë. Në periudhën 1996-2001 ishte Drejtor i Teatrit të Kombësive (Drama Shqipe). Një kohë ishte mësimdhënës në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Tetovës. (Kushtrim Bekteshi)

MUSA Ehat (1949-). Kitarist, muzikant. Lindi në Pejë. Pas shkollës fillore në vendlindje tregoi prirje muzikore dhe dashuri për instrumentin e kitarës, që e kishte zgjedhur që në rininë e



EHAT MUSA

hershme. Kreu me sukses “Ecole Normale de Musique de Paris” (prof. A. Ponce), ku u vendos me banim. Në Francë, në Itali dhe në vende të tjera kreu edhe kurse specializuese për kitarë sidomos me kitaristin dhe pedagogun e njohur A. Dias, duke u thelluar sidomos në muzikën e Amerikës Jugore dhe kompozitorët e saj (A. Barrios, A. Lauro, A. Ponce). Përpos pjesëmarrjes me recitale dhe koncerte në Francë, Itali, Amerikë, ish-Jugosllavi, Shqipëri e Kosovë, është dhe pedagog i master-kurseve në vende të ndryshme. Duke qenë i stabilizuar në Paris, ka vazhduar me aktivitete koncertore e peda-

gogjike, me prezantime recitalesh e koncertesh në salla e qendra vendesh të ndryshme europiane dhe jashtë saj, me renome e trashëgimi të vjetër muzikore. Ka bërë incizime në shtëpi të njohura radiotelevizive dhe te firmat me traditë prodhimesh të LP-disqeve, kasetave e CD-ve me vepra kompozitorësh të njohur evropianë (J. S. Bach), posaçërisht të atyre nga Spanja dhe Amerika Jugore, pa harruar të përfshijë edhe autorët tanë (Z. Ballata, R. Rudi, R. Dhomi etj.). Jeton dhe vepron në Paris. (Zeqirja Ballata)

MUSA Emin (1956-). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Lindi në Bajgorë. Kreu Shkollën e Lartë Pedagogjike në Gjakovë. Punoi në shkollat fillore në Kaçanoll, në Bajgorë dhe në paralelet e gjimnazit në Bare. Ishte organizator dhe pjesëmarrës aktiv i shumë tubimeve, protestave dhe demonstratave nga viti 1989 e më pas. Në vitin 1992 një kohë qëndroi në Gjermani, ku mori pjesë në aktivitete politike të mërgimtarëve kosovarë. Ishte pjesëtar i celulave të para të UÇK-së në Shalë, nga janari i vitit 1998 dhe njëri ndër themeluesit e njësiteve të para të Brigadës 141 “Mehë Uka”, më pas ndihmëskomandant i brigadës. Mori pjesë në shumë beteja, si në Mazhiq, Bajgorë, Taraxhë, Rahovë etj. Në krye të njësisë speciale të brigadës i erdhi në ndihmë Artakollit e Çiçavicës në shkurt dhe mars të vitit 1999. Pas çlirimit punoi në Trupat Mbrojtëse të Kosovës dhe në Forcën e Sigurisë së Kosovës. (Sabit Sylja)

MUSA Izet (1946-). Pedagog, veprimtar i arsimit. Lindi në Pozhar, komuna e Deçanit. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa gjimnazin pedagogjik në Pejë. Studioi pedagogjinë në Fakultetin Filozofik të Prishtinës, ku edhe magjistroi më 1987. N vitet 1968-1976 ishte pedagog shkolle, mësimdhënës dhe drejtor i institucionit parashkollor “Ganimete Tërbeshi” në Gjakovë. Në periudhën 1976-2012 ishte këshilltar pedagogjik në Entin Pedagogjik Rajonal në Pejë. U angazhua për mbijetesën e shkollës shqipe dhe avancimin e metodologjisë së mësimdhënies. U angazhua edhe si mësimdhënës i lëndëve pedagogjike në Fakultetin e Edukimit në Gjakovë. (Afërdita Kumnova-Mulla)

MUSA Nevruz (1942-). Piktur. Lindi në Gjakovë, ku kreu shkollën fillore, ndërsa të mesmen e kreu në Zagreb. Kreu Akademinë

e Arteve (drejtimi i pikturës) në Prishtinë (1980). Punoi disa vjet si ilustrator në Industrinë e Artizanaleve (IKOM) të Zagrebit. Pas kthimit në Prishtinë (1968), punoi në Entin e Teksteve dhe të Mjeteve Mësimore si ilustrator dhe redaktor teknik. Ishte dizajner në Agrokompleksin “Agrokosova”, pastaj ilustrator në të përditëshmen “Rilindja” (më vonë “Bujku”) gjatë viteve 1994-1999. Realizoi gjashtë ekspozita personale në vend dhe dy në Tiranë. Me punimet e tij mori pjesë në disa ekspozita kolektive brenda dhe jashtë vendit. (Blerim Luzha)

MUSA Ramiz (1929-1986). Mësimdhënës. Lindi në Gjakovë, ku kreu shkollën fillore dhe shkollën normale. Kreu, gjithashtu, edhe Shkollën e Lartë Pedagogjike në Beograd dhe studimet për matematikë në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore në Prishtinë. Punën e mësimdhënësit e filloi në vitin 1948, si mësues në Suharekë, pastaj mësimdhënës në progjimnazin e Deçanit, në gjimnazin e Gjakovës, në Shkollën Normale të Prishtinës, përkatësisht në Shkollën e Lartë Pedagogjike të Prishtinës, ku ishte edhe zëvendës drejtor. Në vitin akademik 1985/86 u zgjodh prorektor i Universitetit të Prishtinës. Ishte autor, bashkautor ose përkthyes i disa teksteve dhe dispencave shkollore. Për kontributin në fushën e arsimit ishte bartës i disa çmimeve dhe mirënjohjeve. (Jusuf Meqa)

MUSA Rrustem (1973-). Mjek i luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), themeluesi i shërbimit sanitar të Brigadës 141 “Mehë Uka” në Shalë. Lindi në Bajgorë të Mitrovicës. Studioi për mjekësi në Universitetin e Prishtinës. Me aktivizimin e grupeve të para të UÇK-së në Shalë, si absolvent i mjekësisë iu bashkua UÇK-së. Ishte ndër themeluesit e shërbimit sanitar në këtë zonë. Me formimin e Brigadës 141 “Mehë Uka” (30 qershor 1998) u emërua shef i shërbimit sanitar në këtë brigadë. Arriti të krijojë një rrjet dhe shërbim shembullor në gjithë territorin e brigadës. Kryente shërbime edhe në Zonën Operative të Llapit deri në ofensivën e shtatorit 1998. Në Spitalin Ushtarak të brigadës me seli në Bare, Bajgorë, Ceceli, Kovaçicë, Vesekoc dhe Sllakoc, përveç ushtarëve të plagosur, morën ndihmë mjekësore edhe mbi 5,000 civilë. Pas luftës mbaroi studimet për mjekësi në Prishtinë dhe specializoi për kirurgji. (Emin Musa)

MUSAJ Ali (1933-1995). Poet. Lindi në Tiranë. Shkollimin fillor dhe gjimnazin i kreu në Gjakovë. Për shkak të sëmundjes ndërpreu shkollimin e rregullt dhe u ballafaqua një periudhë të gjatë me probleme shëndetësore. Ka punuar si përkthyes deri në vitin 1976, kur u pensionua. Në fillim shkroi poezi për fëmijë dhe më pas iu përkushtua poezisë për të rritur. Veprat e tij të botuara janë: “Vetëm jehona” (1963), “Shkallëzimet e frikës” (1977), “Katarzë” (1978), “Zëri i vetmisë” (1982) dhe vepra e botuar pas vdekjes “Dritëhijet e jetës” (2002). Në vitin 2013 u botua vepra e tij e zgjedhur në dy vëllime me titullin “Poezi”. (Sali Bashota)

MUSAJ Alush (1970-). Inxhinieri i veterinarisë, profesor universiteti. Lindi në Lubizhdë të Hasit, ku kreu shkollën fillore, ndërsa të mesmen e përfundoi në Mitrovicë. Kreu studimet




ALUSH MUSAJ

në Fakultetin e Bujqësisë të Universitetit të Tiranës, ku mbaroi edhe studimet pasuniversitare dhe mbrojti tezën e disertacionit të doktoratës. Pas studimeve punoi si inspektor sanitar në Ministrinë e Shëndetësisë, më pas ishte drejtor i Inspeksionit në Mitrovicë, ndërsa në vitin 2010 u zgjodh kryetar i këshillit shkencor në Agjencinë e Ushqimit dhe të Veterinarisë. Në vitin 2007 u zgjodh asistent në Fakultetin e Xehetarisë dhe të Metalurgjisë dhe në vijim gradohet me tituj të tjerë universitarë. Është autor dhe bashkautor i disa publikimeve profesionale-shkencore dhe udhëheqës e pjesëmarrës në disa projekte nga fusha e ushqimit. Kreu funksione drejtuese në Fakultetin e Gjeoshkencës dhe në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë. (Izet Zeqiri)

MUSAJ Fatmira (1952-). Historiane. Lindi në Kukës. Shkollimin fillor dhe të mesëm i kreu në vendlindje. Diplomoi në Fakultetin Histori-Filologji në Universitetin e Tiranës (1976). Në vitin 1979 u punësua në Institutin e Historisë, në sektorin e historisë së Kosovës. Në vitin 1986 me studimin “Veprimtaria e Isa Boletinit në Lëvizjen Kombëtare (1864-1916)” fitoi gradën shkencore kandidat i shkencave. Nga viti 1994 u angazhua pedagoge në shkollën e doktoratës në Institutin e Historisë, Qendra

e Studimeve Albanologjike në Tiranë dhe pedagoge e jashtme në Fakultetin Histori-Filologji. Është anëtare e redaksisë së revistës “Studime historike”. Hulumton dhe studion historinë e Kosovës dhe në veçanti figurën e Isa Boletinit dhe të personaliteteve kosovare si dhe rolin e gruas shqiptare përgjatë shek. XIX-XX. Botoi një varg punimesh në revista shkencore brenda dhe jashtë vendit. Mori pjesë në shumë simpoziume dhe konferenca shkencore në Shqipëri e jashtë saj. Është autore e veprave: “Isa Boletini 1864-1916” (1987, ribotuar 2004 dhe 2015); “Gruaja në Shqipëri 1912-1939 (2002). Është bashkautore në disa botime enciklopedike dhe monografike. (Fitim Rifati)

MUSLIU Beqir (1945-1996). Poet, prozator, dramaturg dhe kritik teatri. Lindi në Gjiilan, ku përfundoi shkollimin fillor e të mesëm. Kreu studimet për gjuhë e letërsi shqipe në Uni-



BEQIR MUSLIU

versitetin e Prishtinës. Një kohë të gjatë punoi si gazetar e redaktor i rubrikës së kulturës në revistën “Zëri i rinisë”. Ishte redaktor përgjegjës i revistës “Plejada”, redaktor shumëvjeçar i revistave “Fjala” dhe “Jeta e re”. Krijimtarinë letrare e nisi si poet, pastaj kaloi në forma të tjera letrare: tregime, romane, drama e radio-drama, për të mbetur sërish te poezia. Më 1965 revista “Jeta e re” ia botoi librin e parë poetik “Rima të shqetsueme”. Pastaj botoi librat e radhës, duke ndërtuar një sistem të vetin poetik e figurativ. Librat e tjerë me poezi janë: “Lulëkuqet e gjakut” (1966), “Kunorë sonetesh” (1968), “Bukurija e zezë” (1968), “Sezamet” (1972), “Parabola” (1976), “Darka e magjisë” (1978). Ndërsa veprat në prozë: “Ndeshtasha”, roman (1973); “Vegullia”, roman (1979); “Mbledhësit e purpurit”, roman (1982); “Krupa”, roman (1989); “Kori i gjelave të vdekur”, tregime (2002) etj. Krijimtaria e tij letrare, pjesë të së cilës u publikuan nëpër revista letrare dhe një pjesë e mbetur në dorëshkrim, u botua pas vdekjes në shtatë vëllime nga Shtëpia Botuese “Faik Konica” (2004), përfshirë këtu edhe vepra të pabotuara më parë, si romanet “Makthi”, “Amullia” dhe “Skërluta”, poemat “Skënderbeu” dhe “Orfeiana” etj. Gjithashtu botoi edhe dramat: “Rropullari” (1978), “Unë

Halil Garria” (1982), “Shtrigani i Gjell-Hanit” (tetralogji, 1989), “Faustiana” (1988), “Rrakullima” (tetrapтик, 1990) etj. Drama “Rropullari” u emitua nga Radio-Prishtina me titull “Vdekja e Gjergjezit” dhe u shpërblye në Festivalin e Radios “Ohri 1978” si teksti më i mirë. I njëjti tekst u vu në skenën e Teatrit të Gjiilanit me titull “Vdekja e turpshme”, kurse TV Prishtina e realizoi si dramë televizive dhe me të mori pjesë në disa festivale jashtë vendit. Krijimtaria letrare e Beqir Musliut u prezantua në disa panorama e antologji të letërsisë në gjuhën shqipe dhe në disa gjuhë të tjera. Në veprën e tij ka funksionalizuar kodet mitike, biblike e historike me topikën dhe figurat e zgjedhura, duke aplikuar mjeshtërinë e organizimit të librave si sistem poetik e letrar. (Agron Gashi)

MUSLIU Fahri (1948-). Gazetar. Lindi në fshatin Zaplluxhë të Dragashit, ku kreu shkollën fillore, ndërsa gjimnazin në Prizren. Studioi gazetarinë në Fakultetin e Shkencave Politike



FAHRI MUSLIU

në Beograd. Punën e gazetarit e nisi më 1968, si bashkëpunëtor i gazetës “Rilindja” dhe i Radio-Prishtinës nga Dragashi, kurse nga viti 1975 shkroi për “Rilindjen” nga Beogradi. Në periudhën 1982-1985 punoi në emisionin në gjuhën shqipe të Radio-Jugosllavisë, pastaj korrespondent i gazetës “Rilindja” nga Beogradi. Bashkëpunoi me disa gazeta të ish-Jugosllavisë. Në vitet 1993-2005 ishte korrespondent i “Zërit të Amerikës” nga Beogradi, pastaj i Radiotelevizionit të Kosovës po nga ky qytet. Ishte anëtar i forumeve të ndryshme për lirinë e medieve dhe të drejtave të njeriut në Serbi. Është autor dhe bashkautor i librave publicistikë “Proceset e montuara ndaj shqiptarëve të Kosovës 1999-2001”, “Tunelet e tmerrit”(2009), “Ditari i një shqiptari në Beograd” (2007), “Masakra e Suharekës, mars 1999” (2010) etj. Përktheu disa libra nga serbokroatishtja në shqip. Jeton në Beograd. (Artan Krasniqi)

MUSLIU Ilmi (1959-). Gazetar i sportit. Lindi në Vërbicë të Zhegocit, komuna e Gjiilanit. Kreu studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës. Filloi të merret me gazetari nga

viti 1985. Punoi në “Rilindje” (“Bujku”) deri në mbyllje të saj në vitin 2001. Nga viti 2004 nisi të punojë në të përditshmen “Kosova sot”. Si korrespondent i sportit nga Gjilani ka bërë raporte për ngjarje të ndryshme sportive, por edhe intervista, reportazhe etj. (Enver Sadiku)

MUSLIU Isak (1970-). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Lindi në Reçak të Shtimes. Në vitin 1989, gjatë kohës sa ishte duke kryer shërbimin ushtarak u arrestua së bashku me tetë shokë të tjerë me akuzën për veprimtari armiqësore. Më 1996 emigroi në Gjermani dhe po atë vit u kthye në Kosovë dhe iu bashkua njësiteve të para të UÇK-së. Ishte bashkëthemelues dhe koordinator i njësiteve të Brigadës 121 dhe të Nënzonës Operative të Nerodimes (gusht 1998). Po në këtë zonë kreu detyrën e komandantit të policisë ushtarake të UÇK-së. Pas luftës u angazhua në ngritjen e institucioneve lokale në Ferizaj dhe rrethinë. Në vitin 2003 u arrestua nga Gjykata Ndërkombëtare e Hagës për krime të luftës në Jugosllavi. Pas përfundimit të gjyqimit, në dhjetor të vitit 2005 u shpall i pafajshëm dhe u kthye në Kosovë. (Ruzhdi Jashari)

MUSLIU Jonuz (1959-2018). Politikan. Lindi në fshatin Konçul të komunës së Bujanocit. Ishte drejtor politik i Ushtrisë Çlirimtare për Preshevë, Medvegje dhe Bujanoc (UÇPMB), që operoi në periudhën ndërmjet viteve 2000 dhe 2001. Me arritjen e Marrëveshjes së Konçulit dhe pas çmilitarizimit të Luginës së Preshevës, J. Musliu themeloi Lëvizjen e Progresit Demokratik (LPD). Ai u zgjodh kryetar i saj, pozitë që e mban edhe sot. Në zgjedhjet lokale të vitit 2008, pas marrëveshjes për koalicion me Partinë për Veprim Demokratik (PVD), u zgjodh kryetar i Kuvendit Komunal të Bujanocit. Pas zgjedhjeve të vitit 2012 nuk arriti ta mbante këtë post, por pas marrëveshjes politike me Partinë Demokratike në maj të vitit 2013, u zgjodh sërish kryetar i Kuvendit Komunal të Bujanocit, funksion që vazhdon ta ushtrojë edhe tani. Në zgjedhjet e fundit për Këshillin Kombëtar Shqiptar në Serbi (26 tetor 2014), J. Musliu u zgjodh kryetar i këtij Këshilli. (Qerim Qerimi).

MUSLIU Murat (1958-). Gazetar, reporter i luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Lindi në Likoc të Skënderajt. Më 1981, ndërsa ishte student, u burgos për shkak të organizimit

të demonstratave dhe u dënua me 13 vjet burg. Pas lirimit nga burgu vazhdoi aktivitetin politik. Ishte udhëheqës i Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut në Skënderaj. Më 28 nëntor 1997 u caktua reporter për Zonën Operative të Drenicës. Raportoi për shumë beteja të UÇK-së në mediumet shqiptare dhe të huaja. Gjatë masakrës së Abrisë depërtoi në vendin e ngjarjes dhe raportoi për krimin e bërë nga forcat policore dhe ushtarake serbe. Si rezultat i këtij raportimi, të nesërmen u mbajt mbledhja e jashtëzakonshme e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, ku u mor vendimi për vendosjen e vëzhguesve ndërkombëtarë (OSBE) në Kosovë. (Ali Uka)

MUSLIU Nebih (1965-). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Lindi në Reçak të Shtimes. UÇK-së iu bashkua në pranverë të vitit 1998 në Llapushnik. Mori pjesë në betejën e Llapushnikut dhe të Fushticës (24 korrik 1998). Ishte ndër themeluesit e pikës së UÇK-së në fshatin Rancë të Shtimes dhe komandant i saj. Në shtator të vitit 1998 në Mollopolc themeloi njësinë speciale, ndërsa në Luzhak ishte themelues dhe përgjegjës i njësitit të UÇK-së, kurse në tetor 1998 themeloi pikën e UÇK-së në Reçak. Në dhjetor të atij viti u emërua zëvendëskomandant i Brigadës 161 “Ahmet Kaçiku” në Mollapolc. Ka marrë pjesë dhe ka udhëhequr betejat në Mollapolc, Petrovë, Jezerc, Reçak e Dremjak. Pas luftës një kohë ishte pjesë e Trupave Mbrojtëse të Kosovës. (Ali Uka)

MUSLIU Ramadan (1954-). Poet, kritik letrar. Lindi në Beguncë të Vitisë. Kreu shkollimin fillor dhe të mesëm në Viti, ndërsa studimet për letërsi dhe gjuhë shqipe në Universitetin e Prishtinës. Fillimet e krijimtarisë së tij letrare janë në poezi dhe kritikë letrare, të cilat edhe mbesin preokupimi kryesor i punës së tij krijuese. Për shumë vjet ishte gazetar në të përditshmen “Rilindja” dhe kryesisht ndoqi produksionin letrar të Kosovës. Në periudhën 1993-2004 punoi si redaktor i kulturës, pastaj si drejtues i së përditshmes “Rilindja”, botim i Tiranës. Në këtë periudhë e ka udhëhequr edhe Shtëpinë Botuese “Eurorilindja” po në Tiranë. Në vitet 2004-2007 ishte deputet i Kuvendi të Kosovës. Veprat e tij me poezi janë: “Parodia e trupit” (1981), “Shqisa e gjashtë” (1983), “Pasqyra e të rrëfyerit” (1987), “Kënga e

Sibilave” (1996), “Në zemrën e gjërave” (2005), pastaj veprat me studime dhe kritikë letrare “Mbindërtimi poetik” (1990), “Konfiguracione narrative” (1998), “Estetika e dallueshme” (2005) dhe “Tangjenta letrare” (2012) Ka botuar librin publicistik “Vetëripërteritja e totalitarizmit” (1998). (Sali Bashota)

MUSOLLI Jeta (1989-). Balerinë. Lindi në Prishtinë, ku kreu shkollën fillore dhe Shkollën e mesme të muzikës “Prenkë Jakova”, ku i mori edhe mësimet për balet. Në trupën e Baletit të Kosovës është e angazhuar që nga viti 2003. Ka luajtur role të ndryshme në shfaqjet: “Don Kishoti”, “Lidhja”, “Balloja e diplomës”, “Othello”, si dhe shumë solo dhe duete në shfaqjet e tjera: “Ping Pong spektër”, “Paganini”, “Bukuroshja e fjetur”, “Carmen”, “Rekuiemi i Verdit”, “Kopshti i shpirtrave”, “Liria ime”, “Fluturimi drejt dritës”, “Oh my God” etj. Gjithashtu ka qenë edhe asistente në shfaqjet e baletit “Fluturimi drejt dritës” “Liria ime”, “She-ra-Zade” “Othello” etj. (Ragip Sylaj)

MUSOLLI Lekë (1949-). Gazetar. Lindi në Gjurakoc të Istogut. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, gjimnazin në Istog, ndërsa studioi në Gjakovë. Punën si gazetar e filloi më 1975 në Radio Prishtinë, ku qëndroi deri më 1990, kur Serbia e mbylli me dhunë Radiotelevizionin e Kosovës. Po atë vit nis punë në Radio-Zagreb, në emisionin e lajmeve për Kosovën. Ndërkohë ishte njëri nga organizatorët e protestave për lirinë e fjalës në Kosovë, që u mbajt në disa qendra europiane. Gjate viteve ‘90 punoi në redaksinë e lajmeve për Kosovën të Televizionit Shqiptar. Pas luftës, në vitin 2001 themeloi Radio-Albën me seli në Klinë, në vitin 2005 drejton gazetën e përditshme “Iliria Post”, ndërsa nga viti 2006 rikthehet në Radio-Kosovë, ku punoi deri në vitin 2014. Është drejtor në Radio-Alba në Klinë. (Ibrahim Berisha)

MUSTAFA Artan (1985-). Gazetar. Lindi në Prishtinë, ku kreu shkollimin fillor dhe të mesëm. Studioi për shkenca politike në Universitetin e Prishtinës dhe më pas në Universitetin “Uppsala” (Suedi) dhe në Universitetin e Vjenës (Austri). Në moshën 16-vjeçare u pranua gazetar i rregullt në të përditshmen “Epoka e re”, pastaj punoi reporter, redaktor, kolumnist dhe recensionist në mediet e Kosovës dhe të

huaja: në Institutin për Raportim në Luftë dhe Paqe (IWPR), agjencinë “Kosova Live”, gazetën “Express”, TV Klan (Shqipëri), Agjencinë Spajnolle të Lajmeve (EFE), portalin “Jeta në Kosovë”, përkatësisht në Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN). Mori një sërë mirënjohjesh dhe çmimesh për punë profesionale. Jeton në Vjenë. (Muhamet Mavraj)

MUSTAFA Astrit (1971-). Klarinetist. Lindi në Prishtinë. Kreu Shkollën e Mesme të Muzikës në Prizren dhe në Prishtinë. Studioi klarinetin në drejtimin teorik-pedagogjik në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës (prof. Q. Bobaj) dhe në drejtimin për klarinet në Akademinë e Arteve në Tiranë (prof. K. Dako). Studimet e magjistraturës i kreu në Fakultetin e Muzikës në Shkup (prof. S. Dimov). Ka koncertuar si solist me Filarmoninë e Kosovës, ku është klarineti i parë nga themelimi. Ekzekutoi në Tiranë (2011) dhe Prishtinë (2012) “Koncertin në f-mol nr.1” të C. M. von Weberit me Orkestrën e Universitetit të Arteve dhe Koncertin për klarinet e orkestër në A-dur (2009) të W. A. Mozartit me Orkestrën e Operës së Shkupit. Është anëtar i Kuintetit frymor “Zadeja”, i Sekstetit ballkanik “ProArte” me artistë nga Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia dhe themelues i Kuartetit të klarinetëve “L. Antoni”, udhëheqës i Ansambllit të klarinetëve “Kamer-Fest” dhe bashkëthemelues i Orkestrës Frymore të Forcës së Sigurisë së Kosovës. Ishte anëtar jurie i garave ndërkombëtare të instrumentistëve të rinj, i Ansambllit “R. Mulliqi”, drejtor i Festivalit “Kosovarja këndon” etj. Është udhëheqës i klasës së klarinetës në Shkollën e Muzikës në Prishtinë dhe profesor i klarinetit në Fakultetin e Arteve të UP-së. (Sami Piraj)

MUSTAFA Avzi (1949-). Pedagog, gjuhëtar, profesor universiteti. Lindi në Greshnicë të Kërçovës, në Shkup kreu shkollën e mesme të mësuesisë, studimet i kreu në Fakultetin Filozofik në Shkup, degën e pedagogjisë (1975). Studimet albanologjike i kreu në Fakultetin e Filologjisë në Shkup (1981). Studimet e magjistraturës i kreu në Universitetin e Zagrebit në degën e pedagogjisë, ndërsa disertacionin e doktoratës e mbrojti në Universitetin e Shkupit nga lëmi i didaktikës së gjuhës (1992). Punoi që nga themelimi në katedrën e gjuhës dhe të letërsisë shqipe të Fakultetit Filozofik në Shkup, ku i arriti të gjithë titujt universitarë. U shqua

edhe për krijimtari shkencore e profesionale. Veprimtaria e tij shkencore përfshin studime monografike, trajtesa të veçanta dhe një numër punimesh shkencore për çështje të ndryshme nga sfera e pedagogjisë dhe e gjuhësisë: “Zhvillimi i shkollimit fillor në gjuhën shqipe në Maqedoni 1945-1975” (1978), “Metodologjia e kërkimeve shkencore në fushë të filologjisë” (2007), “Variacione gjuhësore” (2008) etj. Është autor i teksteve shkollore, si dhe i “Abetares” (2002) për nxënësit shqiptarë në Maqedoni. (Fadbi Osmani)

MUSTAFA Bajram (1955-). Inxhinier i makinerisë, mësimdhënës universitar. Lindi në Mitrovicë, ku kreu shkollën fillore dhe të mesme. Kreu studimet në Fakultetin e Makinerisë të Universitetit të Prishtinës (1978), kurse ato pa-universitare në Fakultetin e Xehetarisë dhe të Metalurgjisë në Mitrovicë. Pas diplomimit punoi në minierën e “Trepçës” në Stantërg (1978) drejtor për mirëmbajtjen e minierës, kurse më vonë ishte këshilltar i drejtorit të Trepçës dhe drejtor i fabrikës në ndërtim të elektropirunëve në Mitrovicë. Gjatë viteve 1992-2005 ishte mësimdhënës në Fakultetin e Xehetarisë dhe të Metalurgjisë, ku mbajti lëndën detajet e makinave. Punoi në kombinatin “Trepça”, ku mori pjesë në disa programe zhvillimore dhe ishte i angazhuar në procesin mësimor në Fakultetin e Gjeoshkencës të Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë. (Asllan Vitaku)

MUSTAFA Behxhet (1960-). Biolog, profesor universitar. Lindi në Stroc të Vushtrrisë. Shkollën e mesme të mjekësisë e kreu në Prishtinë dhe studimet për biologji në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore (FSHMN) të Universitetit të Prishtinës (UP). Studimet pa-universitare i kreu në Universitetin e Zagrebit (1990) dhe tezën e doktoratës e mbrojti në FSHMN në vitin 1993. Në vitin 1984 zgjidhet



BEHXHET MUSTAFA

het asistent në departamentin e biologjisë të FSHMN-së, ku i merr të gjitha gradat universitare. Botoi punime shkencore dhe profesionale në revista të ndryshme brenda dhe jashtë vendit dhe mori pjesë në konferenca të ndryshme shkencore. Fushat e veprimtarisë

së tij shkencore janë ekofiziologjia dhe eko-anatomia, konservimi i natyrës, etnobotanika dhe fotokimia. Shtëpia Botuese “Springer” në Nju-Jork i ka botuar dy kapituj të tij në librin shkencor “Etnobotanika dhe diversiteti biokultural në Ballkan”. Është bashkautor i teksteve universitare “Fitocenologji me fitogjeografi”, “Ekologji e bimëve” etj., i dispensave universitare, teksteve shkollore dhe ka udhëhequr disa projekte shkencore. Nga viti 1995 deri më 2017 ka mbajtur ligjërata dhe në Universitetin e Tetovës. Është kryetar i Shoqatës së Ekologëve të Kosovës dhe anëtar i Shoqatës Ndërkombëtare të Shkencave të Hortikulturës. Ka fituar çmim nga UNDP-ja për artikujt për çështjet mjedisore dhe nga Ministria e Arsimit e Kosovës është shpallur “Shkencëtar i vitit 2013”. (Fetah Halili)

MUSTAFA Berat (1944-). Gazetar. Lindi në fshatin Elezaj të komunës së Kaçanikut. Shkollën fillore e përfundoi në vendlindje, ndërsa shkollën normale në Gjilan. Punoi mësues, ndërkaq më 1971 nis punën e gazetarit në të përditshmen “Rilindja” të Prishtinës, ku për një periudhë ishte redaktor i faqes “Prishtina dje, sot, nesër”. Gjatë punës së gazetarit ndoqi ngjarjet në komunën e Prishtinës dhe punën e institucioneve të ndryshme shoqërore, ekonomike, politike etj. Një kohë ishte edhe korrespondent i gazetës “Rilindja” nga komuna e Ferizajt. Pas luftës punoi në të përditshmen “Pavarësia”. Në periudhën 1999-2005 ishte sekretar i Partisë Fshatare të Kosovës. (Shefqet Rexhepi)

MUSTAFA Daut (1918-2009). Mjek, pneumoftiziolog, ligjërues i lartë. Lindi në Prishtinë, shkollimin e kreu në vendlindje, u diplomua në Fakultetin e Mjekësisë në Zagreb (1943). U emërua mjek në spitalin e Prishtinës, ndërsa më 1945 u mobilizua dhe kreu shërbime mjekësore në njësitet ushtarake. Po atë vit u demobilizua dhe u emërua mjek i rrethit të Prishtinës, më pas u transferua në Gjakovë, ku punoi në



DAUT MUSTAFA

ambulancë dhe stacionar me 40 shtretër. Pas shtatë muajsh shërbimi në Gjakovë, u dërgua në Beograd për të ndjekur kursin pesëmujor

nga lëmi i ftziologjisë. Pas kursit, dy muaj punoi në dispanserinë me stacionar në Pejë. Në dhjetor 1946 u transferua në Prizren, ku organizoi dispanserinë antituberkulare me stacionar dhe ku punoi derisa u pensionua në vitin 1985. Specializimin nga ftziologjia e kreu më 1950. Brenda kësaj kohe hapi dhe organizoi dispanserinë antituberkulare në Gjakovë (1951), pastaj në Suharekë dhe në Rahovec (1964). Po në këtë kohë u angazhua si ligjërues në shkollën e infermierëve në Prizren. Me hapjen e Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë u zgjodh ligjërues i lartë në katedrën e pneumoftziologjisë dhe deri në shtator 1987 kreu edhe detyrën e shefit të katedrës. Gjatë njëzet e dy viteve të para të shërbimit të Prizren udhëhoqi shërbimin për sëmundje të mushkërive dhe të tuberkulozit, ndërsa tetë vitet e pastajme udhëhoqi Qendrën Medicinale në Prizren. Dha kontribut të madh në luftën kundër tuberkulozit. Është bashkautor i tekstit “Pneumoftziologjia” (1986) dhe i disa artikujve shkencorë dhe studimorë. Ishte bartës i shumë mirënjohjeve dhe dekoratave. Emrin e tij e mban Qendra Mjekësore Rajonale në Prizren (2005). (Isuf Dedushaj)

MUSTAFA Isa (1951-). Ekonomist, profesor universitar, akademik, politikan. Lindi në Prapashticë, komuna e Prishtinës, shkolllimin fillor dhe të mesëm i kreu në Prishtinë,



ISA MUSTAFA

ku mbaroi Fakultetin Ekonomik. Magjistroi në Fakultetin e Shkencave Organizative të Universitetit të Beogradit (1985), nga fusha e menaxhmentit financiar dhe doktoroi në Universitetin e Prishtinës (2001) në fushën e lidershipit në ekonomi. Nga viti 1976 është profesor i lëndës së mikroekonomisë në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës. Në vitin 2008 u zgjodh anëtar korrespondent dhe më 2012 anëtar i rregullt i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Përpos punës universitare, një kohë ishte kryetar i qeverisë komunale të Prishtinës, drejtor i Entit për Planifikim dhe Zhvillim të Kosovës, anëtar i Qeverisë së Republikës së Kosovës në emigrim (1991-1999) dhe bashkëpunëtor shkencor dhe nënkryetar i Institutit “Riinvest”. Në periudhën 2008-2011

ishte kryetar i Komunës së Prishtinës, në vitin 2014 u zgjodh kryetar i Lidhjes Demokratike të Kosovës. Botoi shumë punime në revistat vendore dhe ndërkombëtare nga fusha e zhvillimit, e strategjisë ekonomike, e relacioneve zhvillimore me vendet e rajonit, e qeverisjes së korporatave, e financimit të rindërtimit dhe zhvillimit, të menaxhimit të sistemit të edukimit, të qëndrueshmërisë buxhetore dhe kulturës tatiimore, të tregut të punës dhe punësimit. Është autor i librave “Udhëheqja, efienca dhe efikasiteti” (2004) dhe “Menaxhmenti financiar” (2005) dhe bashkautor i tri teksteve për shkolla të mesme nga ekonomia. Ka marrë pjesë në disa vizita studimore dhe këmbime profesionale në universitete të jashtme. Në dhjetor të vitit 2014 u zgjodh kryeministër i Qeverisë së Republikës së Kosovës. (Drita Kongjeli)

MUSTAFA Isak (1942-). Ekonomist, profesor universiteti. Lindi në Rimanishtë, komuna e Prishtinës, Fakultetin Ekonomik e kreu në Prishtinë (1965), magjistroi në Zagreb (1969) dhe doktoroi në Universitetin e Beogradit (1979). Punoi si profesor në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës, në Fakultetin e Biznesit në Pejë dhe në Fakultetin Ekonomik në Shkodër. Ushtrroi detyra udhëheqëse në strukturat institucionale të Universitetit të Prishtinës dhe në Fakultetin e Biznesit në Pejë. Për shumë vjet ka qenë drejtor i Qendrës për Produktivitet dhe Inovacione të Kosovës, anëtar i Këshillit Ndërkombëtar për Biznese të Vogla (ICSB), kryetar i Konferencës Ndërkombëtare të Biznesit dhe Punësimit. Është autor i shumë librave shkencorë dhe teksteve universitare, si “Ekonomia e ndërmarrjes” (1972), “Organizimi i sistemit financiar dhe ndikimi i tij në zhvillimin e ndërmarrjeve industriale të Kosovës” (1980), “Puna në biznes” (1991), “Biznesi në ekonominë e tregut” (1992), “Ndërmarrja në biznesin bashkëkohor” (1997), “Krijimi dhe zhvillimi i bizneseve” (2004), “Menaxhimi i biznesit dhe i punësimit në ekonominë bashkëkohore” (2013). Në studime pasdoktorale ka qëndruar në SHBA dhe në Britani të Madhe, si dhe ka marrë pjesë në shumë konferenca shkencore brenda dhe jashtë vendit. (Drita Kongjeli).

MUSTAFA Leutrim (1990-). Gazetar i sportit. Lindi në Prishtinë. Shkollën fillore e kreu në Gllamnik, ndërkaq të mesmen në Podujevë. Kreu studimet për gazetari në Fakultetin e

Filologjisë të Universitetit të Prishtinës. Punën si gazetar i sportit e filloi në vitin 2009 në të përditshmen "Sport", ku punoi deri në vitin 2013. Me daljen e gazetës së re sportive "Sport plus" kreu detyrën e redaktorit përgjegjës, ndërsa më vonë edhe të kryeredaktorit të saj. (Florim Maliqaj)

MUSTAFA Muhamet (1950-). Ekonomist, profesor universiteti, politikan. Lindi në Rimanishtë të Prishtinës, shkollimin fillor dhe të mesëm i kreu në Podujevë, ndërsa u diplomua në Fakultetin Eko-



MUHAMET
MUSTAFA

nomik të Universitetit të Prishtinës (1973). Studimet pasuniversitare i vijoi në Zagreb dhe u doktorua në Beograd (1985) në fushën e menaxhimit të zhvillimit dhe investimeve. Qëndroi disa herë për kërkime studimore në universitete të ndryshme jashtë vendit. Në vitin 1987 u zgjodh docent në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës për lëndën kibernetika në ekonomi, duke u avancuar më pas në të gjithë titujt universitarë. Më 1995, bashkë me një grup bashkëpunëtorësh, themeloi Institutin "Riinvest" dhe më 2007 kolegjin e studimeve universitare po me këtë emër. Ka botuar punime shkencore në revista vendore dhe ndërkombëtare nga fusha e ekonomisë dhe e menaxhimit të zhvillimit dhe ka udhëhequr disa projekte ndërkombëtare për zhvillimin ekonomik të Kosovës. Është autor i disa monografive dhe i teksteve universitare ("Politika e të ardhurave dhe produktiviteti i punës", "Organizimi i sistemeve të investimeve në Kosovë", "Kibernetikë dhe hyrje në informatikë", "Menaxhimi i investimeve"). M. Mustafa ka kryer edhe një sërë funksionesh politike, kryesisht në sektorë të ekonomisë, si drejtor i Fondit të Kosovës për Rrugë (BVI), ministër i Zhvillimit në Qeverinë e Kosovës dhe ministër i Zhvillimit në Qeverinë Federale të Jugosllavisë deri në shkurt të vitit 1989, kur hiqet dhe dënohet për shkak të qëndrimeve kundër politikës së atëhershme. Një kohë ka ushtruar edhe gazetarinë në gazetën "Rilindja" dhe në revistën "Zëri i rinisë", pastaj aktivist i organizatës së rinisë së Kosovës dhe kryetar i saj. Në bisedimet e Vjenës për statusin e Kosovës (2005-2006) ka udhëhequr ekipin e ekspertëve

të ekonomisë, ndërsa për dy mandate (nga viti 2010) është deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës. (Ramiz Livoreka)

MUSTAFA Myzafere (1947-). Studiuose e lehtësisë gojore. Lindi në Pejë, ku kreu shkollën fillore dhe gjimnazin, kurse studimet e larta për gjuhë dhe letërsi shqipe i kreu në Universitetin



MYZAFERE
MUSTAFA

e Prishtinës (1972). Po në këtë universitet kreu studimet pasuniversitare dhe mbrojti tezën e doktoratës nga shkencat filologjike (2001). Nga viti 1973 punoi në Institutin Albanologjik në Prishtinë, dega e folklorit, në fillim si hulumtuose dhe më pas si këshilltare shkencore. Për disa vjet ishte përgjegjëse e degës së folklorit në këtë institut dhe kryeredaktore e revistës shkencore "Gjurmime Albanologjike", seria folklor dhe etnologji. Është marrë kryesisht me studimin e prozës gojore. Ka botuar veprat studimore: "Përralla shqiptare - Poetika dhe mitikja" (2003), "Proza gojore - Teksti dhe konteksti" (2005) dhe si bashkautore ka përgatitur vëllimet me materiale folklorike: "Këngë dashurie I, II" (1979, 1987), "Antologji e përrallës shqipe" (1982), "Kallëzime" (1987), "Këngë kreshnike" (1993), "Fabula" (2008) etj. (Leontina Musa)

MUSTAFA Nazmi (1924-1997). Inxhinier i xehetarisë, aktivist politik. Lindi në fshatin Rimanishtë të Prishtinës. Shkollën e mesme të xehetarisë e kreu në Bor dhe më pas zë punë në minierën e Kishnicës. Studimet i kreu në Fakultetin e Xehetarisë në Tuzëll (1963). Pas studimeve, punësohet në minierën e Goleshit, ku kreu edhe detyrën e drejtorit të përgjithshëm të minierës (1964-1968). Ishte nënkryetar i Odës Ekonomike të Kosovës (1968-1970), kurse më pas u zgjodh drejtor i prodhimit në mihjen sipërfaqësore të Mirashit. Në periudhën 1972-1978 ishte kryetar i komunës së Prishtinës, ku la gjurmë të dukshme me disa masa radikale në urbanizëm dhe në tejkalimin e mentalitetit të vjetër, duke i dhënë Prishtinës strukturë urbane bashkëkohore. Më pas ishte drejtor i ndërmarrjes Kishinicë-Novobërdë dhe drejtor i Kombinatit ndërtimor "Ramiz Sadiku" në Prishtinë. Kreu edhe një varg

funksionesh: kryetar i Pleqësisë për Zhvillim Ekonomik të Kosovës, anëtar i Kuvendit të KSA të Kosovës, deputet i Parlamentit të ish-Jugosllavisë etj. (Shyqeri Kelmendi)

MUSTAFA Nexhat (1933-2004). Mësues, shkrimtar, dramaturg. Lindi në Strugë. Kreu shkollën fillore në vendlindje, të mesmen në Shkup e Tetovë, kurse Shkollën e Lartë Pedagogjike në Shkup. Pas punës dyvjeçare si mësues në Gjorçe Petrov të Shkupit dhe më pas në Strugë, kreu studimet për biologji në Universitetin e Prishtinës, ndërsa studimet pasuniversitare i kreu në Universitetin e Zagrebit. Në shtator të vitit 1960 themeloi gjimnazin e Strugës, ku punoi si mësues. Në Strugë u mor edhe me aktivitete kulturore, ndërsa më pas dha kontribut në themelimin e Universitetit të Tetovës. U shqua edhe si krijues letrar. Në vitin 1973 botoi përmbledhjen poetike “Kur bulzat shpërthejnë” dhe me dramën “Gjaku”, e cila u vu në skenë nga Teatri i Kombësive të Shkupit. Shkroi edhe dramat: “Leka i Madh”, “Pesha e dheut”, “Dervish Cara”, etj. Dramën “Ujë e kripë” e vuri në skenë Teatri i Prishtinës, ndërsa Radio-Shkupi realizoi radiodramat “Jeta” dhe “Përmendorja”, ndërkaq në gjuhën maqedonase radiodramën “Mall e dashuri”. Vepra e tij e fundit qe libri i dramave “Shpëtimi nga Golgota”. Botoi edhe një sërë shkrimesh në revista e gazeta. (Fatmir Sulejmani)

MUSTAFA Ragmi (1962-). Politikan. Lind në në fshatin Zhunicë të komunës së Preshevës. Diplomoi në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike të Universitetit të Prishtinës. Nga viti 1987 deri në 2004, punoi mësues në gjimnazin “Skënderbeu” në Preshevë. Në maj të vitit 2003 u zgjodh kryetar i Partisë Demokratike Shqiptare (PDSH) në Preshevë, në nëntor të vitit 2004 zgjidhet kryetar i Kuvendit Komunal të Preshevës, ndërsa në qershor 2006 kryetar i komunës së Preshevës, në zgjedhjet lokale të atij viti. Më 11 maj 2008 u rizgjodh kryetar i Kuvendit Komunal deri më 20 maj 2009, kur u zgjodh sërish kryetar i komunës së Preshevës. (Qerim Qerimi).

MUSTAFA Rrustem (1971-). Komandant i Zonës Operative të Llapit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Lindi në PërPELLAC të komunës së Podujevës. Pas përfundimit të

shkollës fillore në vendlindje dhe të mesmes në Podujevë, kreu studimet në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës. Që herët u bë pjesë e lëvizjes së rezistencës. Më 1996 u përfshi në strukturat ushtarake të UÇK-së. Pas vrasjes së Zahir Pajazitit, më 31 janar 1997, mori përsipër zgjerimin dhe konsolidimin e radhëve të UÇK-së. Në gusht të vitit 1997 shkoi në Shqipëri, ku takoi shumë bashkëlufëtare me të cilët u morën vesh për koordinimin e aktiviteteve të UÇK-së në Llap. Në fillim të shatorit të vitit 1997 u emërua përgjegjës dhe koordinator i Nënzonës Operative të Llapit (NZOPLL), me disa nënzona të tjera dhe me Shtabin Qendror të UÇK-së. Kontaktoi me Fatmir Humollin, që ishte përgjegjës i krahit ushtarak të Lëvizjes Kombëtare për Çlirimin e Kosovës (LKÇK) dhe u pajtuan për bashkërendim të aktiviteteve. Në fillim të majit të vitit 1998 në një takim me Rrahman Ramën (më vonë komandant i Zonës Operative të Shalës), marrin vendim për daljen publike të UÇK-së dhe krijimin e qendrës së saj rekrutuese dhe stërvitore në Zabërgjë të Shalës. Kjo u realizua më 6 qershor 1998. Në takimin e strukturave të NZOLL-it, më 18 korrik 1998 në Bajgorë u vendos që komandant i kësaj nënzona të emërohet Rr. Mustafa, që njihej me nofkën “Remi”. Një delegacion i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së vizitoi shtabin e nënzonës në Bajgorë të Shalës më 17 dhe 18 gusht të vitit 1998 dhe zyrtarizoi strukturën komanduese të kësaj nënzona me Rr. Mustafën-Remin komandant. Pas përfundimit të luftës mori gradën e gjeneralmajorit. Deri më 2001 ishte epror i lartë i Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK), komandant i Zonës V të TMK-së me seli në Prishtinë, pastaj i Zonës VI me seli në Gjiilan. Më pas u angazhua në politikë, duke u bërë pjesë e Partisë Demokratike të Kosovës. (Ismet Cakiqi)

MUSTAFA Shaip (1912-1964). Jurist, aktivist i Partisë Komuniste të Jugosllavisë (PKJ), nacionalist. Lindi në Preshevë. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, Medresenë e Madhe në Shkup, Fakultetin e Drejtësisë në Beograd (1939). Ishte anëtar i organizatës studentore ilegale “Besa” në Beograd (1935) dhe sekretar i organizatës së PKJ-së për Preshevë (1938-1941). Organizoi demonstratën e njohur të shqiptarëve në Shkup më 1941, në të cilën u kërkua që Shkupi, Kumanova, Presheva,

Kaçaniku dhe viset e tjera shqiptare të okupuara nga Bullgaria, të bashkohen me Shqipërinë. Organet e pushtetit bullgar e arrestojnë dhe e internojnë në Teteven të Bullgarisë. Më vonë punoi si gjykatës në Tetovë (1942), por pas demonstratave të Tetovës të shkurtit të vitit 1942, transferohet në Kërçovë. Më 1943 caktohet prokuror në Gjyqin e Qarkut të Prishtinës. Kërkoj që Partia Komuniste e Maqedonisë t'i bashkohet Partisë Komuniste të Shqipërisë. Një kërkesë e tillë u konsiderua si nacionaliste dhe Komiteti i vendit i PKJ-së për Tetovë e përjashtoi nga radhët e veta (1942). Arrestohet nga gjermanët dhe internohet në Vjenë (1944-1945). Gjatë Luftës së Dytë Botërore, për shkak të statusit të ardhshëm të Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare, bie në konflikt me Svetozar Vukmanoviq-Temepon. Pas luftës u zgjodh sekretar i Gjyqit të Rrethit të Prishtinës. Në vitin 1947 arrestohet nga pushteti jugosllav, akuzohet për spiunazh në shërbim të Italisë, për organizim dhe udhëheqje të organizatës "Besa" për llogari të shërbimit Italian. Pushteti i atëhershëm e dënoi me vdekje (1948). Nga burgu lirohet më 1962. Vdiq në Preshevë. (Illir Zylfiu)

MUSTAFA Sherafedin (1929-1994). Farmacist. Lindi në Prishtinë, shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në Prishtinë, studimet i kreu në Fakultetin e Farmacisë në Beograd (1957).



SHERAFEDIN
MUSTAFA

Në fillim u punësua në barnatoren e Spitalit të Përgjithshëm të Prishtinës, si farmacisti i parë shqiptar në Kosovë. Në vitin 1960 jep mësim edhe në Shkollën e Mesme të Mjekësisë në Prishtinë, e cila posa ishte hapur. Po në vitin 1960 u transferua në Entin Higjienik të Kosovës, ku punoi në laboratorin e bromatologjisë (kimisë sanitare). Në vitin 1961 kreu dhe specializimin për kimi sanitare dhe u emërua udhëheqës i laboratorit të bromatologjisë në kuadër të Entit Higjienik. U bë specialisti i parë shqiptar i kimisë sanitare (bromatologjisë) në Kosovë. Në vitin 1968 kaloi me punë në barnatoren e Obiliqit, e cila ishte në kuadër të barnatoreve të integruara të Prishtinës, ku punoi deri në vitin 1969. Në fund të vitit 1969 u dërgua në barnatoren e qytetit në

Podujevë, e cila ishte e vetmja që shërbente për më shumë se 50 mijë banorë. Në Podujevë punoi deri në vitin 1990. (Amir Agani)

MUSTAFA Xhemail (1953-2000). Shkrimtar, publicist, veprimtar politik. Lindi në Gllanik të Podujevës. Kreu shkollimin fillor dhe të mesëm në vendlindje dhe në Podujevë, më



XHEMAIL
MUSTAFA

pas ndoqi studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin e Filologjisë në Prishtinë. Njëkohësisht ndoqi studimet edhe për gazetari. Në vitin 1978 nis të punojë në gazetën "Rilindja", fillimisht si gazetar i rubrikës së kulturës e më vonë edhe redaktor i saj. Në gazetën "Rilindja" dhe në periodikun e Kosovës botoi recensione, vështrime dhe ese për vepra letrare dhe për çështje të kulturës. Në fund të viteve '80 dhe në fillim të viteve '90 u përfshi në zhvillimet politike të kohës, duke u bërë njëri nga themeluesit e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK). Më pas për shumë vjet ishte anëtar i kryesisë së LDK-së dhe zëdhënës i saj. Në vitin 1998 botoi veprën me vështrime kritike "Mrekullia e shkrimit" dhe dy vjet më vonë botoi librin e tij të dytë "Një lutje për Prishtinën" (2000). Në këtë vepër përshkroi ditët dhe netët e tmerit në Prishtinën në kohën e bombardimeve të NATO-s dhe të gjendjes së terrorit që ushtronin forcat serbe mbi qytetarët e Kosovës. Vepra është e ndërtuar në formë të një ditari për "78 net të frikës, kurajës dhe shpresës", sa zgjati operacioni i NATO-s në caqet serbe në Kosovë dhe Serbi. Xh. Mustafa u vra në një atentat afër banesës së tij në Prishtinë, më 23 nëntor 2000. Në vitin 2004 një shkollë fillore në Prishtinë mori emrin e tij, ndërsa në vitin 2012 Fondacioni "Ibrahim Rugova" botoi krijimtarinë e plotë të Xh. Mustafës në dy vëllime. (Sali Bashota)

MUSHKOLAJ Gjylieta (1963-). Juriste, profesore universitare, anëtare korrespondent e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Diplomoi për drejtësi në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës më 1986. Studimet pasuniversitare i mbaroi në Universitetin e Europës Qendrore (Central European University) në Budapest



GJYLIETA
MUSHKOLAJ

të Hungarisë. Magjistraturën e dytë dhe studimet e doktoraturës nga fusha e të drejtës kushtetuese i mbaroi në Universitetin e Prishtinës (UP) në vitin 2007. Është profesore në Fakultetin Juridik të UP-së. Në periudhën

2009-2012 ishte gjykatëse në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës. Ka ushtruar detyra në institucionet juridike të Kosovës, si: anëtare e Komisionit Kushtetues të Republikës së Kosovës, anëtare e grupit për themelimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, eksperte për decentralizim e Ekipit Negociator të Kosovës, anëtare e Komisionit për Provimin e Jurisprudencës etj. Në vitin 2016 u zgjodh anëtar korrespondent e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. (Qerim Qerimi).

MUSHKOLAJ Imer (1977-). Gazetar. Lindi në Deçan, ku mbaroi shkollimin fillor dhe të mesëm. Mbaroi studimet për gazetari, aktrim dhe menaxhment. Kreu trajnime në disa vende të Europës. Punoi si gazetar dhe redaktor në media vendore dhe bashkëpunoi me shumë të tjera ndërkombëtare. U mor edhe me kritikë filmi e teatri. Gjatë viteve 1998 dhe 1999 punoi në gazetën e studentëve “Bota e re”, pastaj në gazetën “Koha ditore” dhe në Institutin për Raportimin e Luftës dhe Paqes (IWPR). Në vitet 2000-2003 ishte redaktor përgjegjës dhe kryeredaktor i gazetës “Epoka e re” dhe i suplementit të saj “Intervista plus”. Bashkëpunoi me gazetën “Java”, për të kaluar në vitet 2004-2007 në të përditshmen “Lajm” si gazetar e redaktor. Themeloi dhe udhëhoqi për një vit edhe revistën “Profil”, ndërkaq dy vjet punoi redaktor në gazetën “Express”. Në vitet 2010-2013 ishte drejtor ekzekutiv i Asociacionit të Gazetarëve Profesionistë të Kosovës (AGPK). Ishte kryetar i Këshillit të Medieve të Shkruara në Kosovë. (Artan Krasniqi)

MUSHTISHTI. Fshat në komunën e Suharekës, rreth 9 km në juglindje të qytetit, në lartësi mbidetare 550-700 m dhe me sipërfaqe 3,244 ha. Shtrihet rrëzë maleve të Sharrit, në skajin lindor të fushës së Prizrenit. Është ndër fshatrat më të mëdhenj në Kosovë. Njihet si vendbanim i vjetër. Në rrethinat e këtij fshati janë gjetur gërmadha

që dëshmojnë për praninë e një municipiumi. Në vitin 1905 kishte 160 shtëpi, kurse në vitin 1948 kishte 276 shtëpi me 2,346 banorë. Deri në regjistrimin e vitit 1961, vendbanimi ishte më i madh se qyteti i Suharekës. Në vlerësimin e vitin 1991 kishte 5,016 banorë, kurse në regjistrimin e vitit 2011, në vendbanim të pranishëm ishin 3,394 banorë (50% e popullsisë jeton jashtë Kosovës). Gjatë luftës së fundit u shkatërruan të gjitha objektet e banimit, përfshirë edhe xhaminë e fshatit (e vitit 1702), bibliotekën dhe objekte të tjera të infrastrukturës. Pas luftës fshati u rindërtua në tërësi, duke ruajtur Kullën e Pashës nga shek. XVII. Mushtishti ka funksionin e bashkësisë lokale për disa fshatra përreth. Fshati ka shkollën 9-vjeçare, qendërën e mjekësisë familjare, qendërën e kulturës, njësi tregtie, njësi të përpunimit të drurit dhe të materialit ndërtimor etj. Popullsia merret kryesisht me bujqësi, pylltari dhe ndërtimtari. (Valbon Bytyçi)

MUZAKAJT. Familje fisnike e Arbërisë Jugore e shek. XIII-XV. Originën e kishte nga zona e Oparit, në perëndim të Korçës. Një fisnik i kësaj dere më 1090 ishte ndër komandantët më të dalluar të perandorit bizantin Aleks I Komnenit (1081-1118). Andrea I Muzaka (1280-1319), gjatë sundimit anzhuin, ishte “mareshal i Arbërisë”. Krijues i Principatës së Muzakajve ka qenë “despoti” Andrea II Muzaka (1335-1372). Qendër e zotërimit të Muzakajve ishte Berati, të cilin e mbajtën për disa kohë. Deri në fillim të viteve ‘70 të shek. XIV ata e zgjeruan zotërimin e tyre në veri deri në jugperëndim të fushës së Kavajës (fshati Gosë), në jug deri në lumin e Vjosës, në perëndim deri në breg të detit Adriatik dhe në lindje deri në Kostur (sot në Greqi). Ata lidhën krushqi me Gropajt e Ohrit dhe Balshajt e Shkodrës. Pas vdekjes së Andreas II Muzaka (1372), zotërimi u dobësua, duke u ndarë midis tre djemve të tij: Gjonit, Teodorit e Stojës. Teodori II Muzaka me ushtrinë e tij mori pjesë në Betejën e Kosovës (1389), ku mbeti i vrarë. Më pas Muzakajt u rrezikuan vazhdimisht nga osmanët, të cilët më 1417 pushtuan Beratin. Disa pinjollë të Muzakajve përqafuan islamizmin dhe u ngjiten në poste të larta të shtetit osman. Njëri prej tyre, Jakup Beu në vitet 30 të shek. XV u bë sanxhakbej i “Sanxhakut Arbër”. Më 1443 Muzakajt u bashkuan me Skënderbeun, duke luftuar përkrah tij. Pas rënies së kështjellave

të fundit në duart e osmanëve, Gjon Muzaka mërgoi në Napoli (Itali), ku më 1510 shkroi memorien “Historia dhe gjenealogjia e shtëpisë së Muzakajve”, një burim i rëndësishëm për historinë mesjetare të Arbërisë. Muzakajt dhanë kontribut të madh në luftërat kundër sundimeve të huaja në Arbëri. (Qerim Dalipi)

MUZBEG Iskender (1947-). Shkrimtar i lehtësisë turke në Kosovë, përkthyes. Lindi në Prizren. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje. U diplomua në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës. Ishte njëri nga themeluesit e javores “Tan” (1969), ku qe për disa vjet redaktor i kulturës. Aktualisht është gjyqtar në Gjykatën Komunale të Prizrenit. Shkruan poezi, prozë, kritikë letrare. Merret me punë shkencore-hulumtuese dhe me përkthime letrare nga gjuha turke në gjuhët e tjera të Ballkanit. Është aktiv në Shoqatën “Dogru Yol” në Prizren. Ka shkruar vjersha, tregime e romane: “Të dashuruarat e djegura” (1970), “Burimi” (1972), “Sevil” (1974), “Të jetosh” (1975). Ka përgatitur dhe botuar monografi dhe libra shkollorë e antologji të poezisë turke në Kosovë. Krijimet e tij letrare janë botuar në shumë përmbledhje e antologji. (Irfan Morina)

MUZETË E KOSOVËS. Institucione publike të Kosovës, që merren me mbledhjen, ruajtjen, dokumentimin, studimin dhe prezentimin e trashëgimisë kulturore-arsimore, natyrore dhe industriale të Kosovës. Në Kosovë ekzistojnë mbi 20 muze, të cilët veprojnë si institucione të pavarur dhe që financohen nga Ministria e Kulturës, e Rinisë dhe e Sportit ose nga kuvendet komunale. Shumica e tyre prezantojnë trashëgiminë kulturore të Kosovës, e disa, trashëgimitë pedagogjike dhe industriale.

Muzeu më i vjetër i Kosovës është Muzeu Kombëtar, i themeluar në Prishtinë në vitin 1949. Është i vendosur në godinën e ndërtuar në fund të shekullit XIX. Muzeu ka karakter kompleks dhe përbëhet nga 4 sektorë: arkeologji, histori, etnografi dhe natyrë. Ndërkaq, muzeu tjetër në Prishtinë, “Shtëpia e Pavarësisë së Kosovës - dr. Ibrahim Rugova” u themelua në vitin 2007 dhe është i vendosur në objektin e dikurshëm të Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës. Ka karakter historik dhe prezanton aktivitetet të kryera

në këtë ndërtesë të udhëhequra nga Ibrahim Rugova për arritjen e pavarësisë së Kosovës. Me historinë më të re të Kosovës lidhet edhe Muzeu “Qëndresa heroike e Jasharëve për liri”, i cili u themelua në vitin 2016 në Kompleksin Memorial në Prekaz. Muzeu ka karakter historik dhe prezanton qëndresën heroike të familjes Jashari në luftën e fundit në Kosovë. Në të është ekspozuar material dokumentar, fotografi, armët personale të komandantit legjendar Adem Jashari, armët e Hamzë Jasharit, predha të mortajave e të topave, me të cilët ishte sulmuar familja Jashari, objekte bujqësore, etnologjike etj. I themeluar viteve të fundit (2006) është edhe Muzeu Etnologjik “Emin Gjiku”, i cili është i vendosur në një shtëpi tradicionale në Prishtinë dhe prezanton trashëgiminë etnokulturore të Kosovës. Karakter muzeor kanë edhe Instituti i Monumenteve dhe Muzeu Rajonal në Prishtinë, që u themeluan në vitin 1967, përkatësisht 1968. Janë të vendosur në një ndërtesë të vogël pranë Kuvendit Komunal të Prishtinës dhe merren me mbrojtjen e monumenteve të trashëgimisë kulturore të Prishtinës dhe me veprimtari muzeologjike.

Nga institucionet që për një kohë më të gjatë zhvillojnë veprimtari muzeore është edhe Kompleksi Monumental i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, i themeluar në vitin 1978, me rastin e 100-vjetorit të Lidhjes. Në këtë kompleks është paraqitur trashëgimia kulturore nga hapësira mbarëshqiptare. Kompleksi ka sektorin e historisë, të etnologjisë dhe të arteve. Në Prizren funksionon edhe Muzeu Arkeologjik, i cili është themeluar në vitin 1975, në Hamamin e Ahmet Beut. Së fundi, më 2013, në Prizren është hapur edhe Muzeu Etnologjik, i cili është vendosur në shtëpinë tradicionale, të restauruar, të Musë Shehzades. Në Pejë, ndërkaq, funksionon Muzeu Rajonal, i themeluar në vitin 1977 dhe i hapur më 1983. Muzeu është i vendosur në konakun e dislokuar të Tahir Beut dhe ka dy sektorë: të arkeologjisë dhe të etnografisë. Karakter rajonal ka edhe Muzeu Etnografik i Gjakovës, i themeluar në vitin 1974. Muzeu është i vendosur në një shtëpi karakteristike qytetare dhe ekspozon trashëgiminë etnologjike dhe historike të Gjakovës dhe të rajonit të saj. Ndërsa Muzeu i qytetit të Mitrovicës u themelua në të njëjtin vit me Muzeun e Kosovës (1949) dhe sot është i vendosur në ndërtesën e ish-Shtëpisë

së Armatës Jugosllave. Muzeu i Mitrovicës gjithashtu ka karakter kompleks dhe përfshin sektorët e arkeologjisë, të historisë, të etnografisë dhe të natyrës.

Në Kosovë funksionojnë edhe disa muze të tjerë të qyteteve, si: në Gjilan, Vushtrri, Skënderaj, Ferizaj, Deçan, Junik, Rahovec, Suharekë, Malishevë dhe Shtime, si dhe disa muze të shkollave (Muzeu i Shkollës së Parë Shqipe në Kosovë, Stubëll; Muzeu i Shkollës së Parë Shqipe në Gjakovë; Muzeu i Shkollës "Selami Hallaqi", Gjilan; Muzeu i Shkollës në Tërpezë, Muzeu i Shkollës në Drenoc etj). Kosova ka edhe tre muze industrialë: Muzeun e Elektroekonomisë së Kosovës në Prizren, Muzeun e Kristaleve të Kosovës "Trepça" në Stantërg dhe Muzeun e Hekurudhave të Kosovës në Fushë-Kosovë. (Shpresa Siqeca)

MUZEU ARKEOLOGJIK I PRIZRENIT.

Muze i parë në rajon me objekte arkeologjike të rrethinës së Prizrenit. Është vendosur në hamamin e ndërtuar në vitin 1498, në afërsi të kishës së Shën Prendës. Në të Eshref pashë Rrotulli ndërtoi edhe Kullën e Sahatit (mesi i shek. XIX). Hamami ku është vendosur muzeu është i mbuluar me pllaka plumbi dhe ka shtatë kupola dhe tre qemerë. Hamami me Sahat Kullë u shndërruan në Muze Arkeologjik në vitin 1975 nga Enti për Mbrojtjen e Monumenteve Kulturore dhe të Natyrës, në Prizren. Në të prezentohen materiale arkeologjike të Prizrenit dhe të komunave përreth dhe këto datojnë nga epoka e neolitit të hershëm deri në mesjetë. Atraktivitetet të veçantë paraqesin objektet nga tumat e epokës së hekurit të Romajës, të lokalitetit të Vërmicës, të Kalasë së Prizrenit, të Manastirit të Kryeengujve, si dhe disa monumente epigrafike të periudhës romake. (Edi Shukriu)

MUZEU I ELEKTROEKONOMISË SË KOSOVËS, PRIZREN. Muze në objektin e hidrocentralit të parë të Kosovës. Nisma për ndërtimin e hidrocentralit të Prizrenit daton nga viti 1907/08, kur prizrenasit Sherif efendi Bujari, Shani Llausha dhe të disa të tjerë në Selanik përpiluan projektin për ndërtimin dhe shfrytëzimin e ndërmarrjes elektrike në Prizren. Pas një viti filloi ndërtimi i hidrocentralit në rrjedhën e Lumëbardhit. Kjo nismë u ndërpre në vitin 1912, me pushtimin e Kosovës nga Serbia. Me kontributin e

qytetarëve dhe të kredive bankare vendore rifilloi ndërtimi i objektit në vitet 1926-1928. Projekti u hartua nga një institut i Vjenës. Prodhimi në "hidroelektranën" e njohur me emrin "Prizrenka", me fuqi prej 160 KVA filloi në vitin 1929. Në vitin 1936 u fut në prodhim edhe generatori i dytë me kapacitet të njëjtë. Hidrocentrali punoi pa ndërprerje deri në vitin 1973. Me rastin e 50-vjetorit të fillimit të punës së "Hidroelektranës", më 1979, Enti për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës të komunës së Prizrenit i shndërroi në muze objektin dhe pajisjet e këtij hidrocentrali. Në sallën e parë të objektit janë konservuar dhe prezantohen të gjitha pajisjet teknike të centralit, ndërsa në sallën e dytë është ekspozuar materiali arkivor i Muzeut. Në oborr, si ekspozat teknik, është vendosur një trafo e vjetër. Objekti i hidrocentralit u shpall monument kulture nga Enti përkatës i komunës së Prizrenit në vitin 1977, mirëpo për shkak të rrethanave politike në Kosovë, Muzeu u la pas dore për një kohë të gjatë (1981-1999). Disa ndërhyrje për sanimin e dëmtimeve të objektit u ndërmorën vitin 2000, kurse më 2012, me mbështetjen e Ambasadës së SHBA-së në Prishtinë, u kryen punët restauruese. Muzeu gjendet në rrugën magjistrale Prizren-Tetovë, 2.5 km larg qytetit. (Parim Kosova)

MUZEU I KOSOVËS. Institucion i trashëgimisë kulturore, i themeluar në vitin 1949. Qëllimi i tij është hulumtimi, mbledhja, ruajtja, restaurim-konservimi dhe prezentimi i trashëgimisë së luajtshme kulturore-historike, që nga parahistoria e deri më sot. Gjendet në bërthamën e vjetër të qendrës së Prishtinës, në objektin e ndërtuar në vitin 1889 dhe të projektuar sipas stilit austro-hungarez, që kishte destinim vendosjen e komandës së lartë ushtarake të kohës. Muzeu ka karakter kompleks dhe në kuadër të tij vepron këto seksione: arkeologjia me epigrafi dhe numizmatikë, etnologjia, historia dhe natyra. Në Muze funksionojnë shërbimet e mbrojtjes së materialit muzeor, dokumentacioni/arkiva dhe biblioteka. Ndërtesa e Muzeut ka tri galeri dhe njëra shërben për ekspozitën e përhershme arkeologjike. Ekspozatet janë prezantuar edhe në oborin e Muzeut dhe në Parkun Arkeologjik. Në bodrume gjenden depot e koleksioneve dhe të artefakteve të luajtshme. Nga viti 1956 botohet revista profesionale-



MUZEU I KOSOVËS NË PRISHTINË

shkencore “Buletini i Muzeut të Kosovës”, si dhe botime të veçanta dhe monografi të ekspozitave tematike. Në kuadër të Muzeut përfshihen edhe kompleksi etnologjik “Emin Gjiku”, i vendosur në ndërtesën e shek. XVIII, dhe Muzeu “Shtëpia e Pavarësisë së Kosovës”. (Milot Berisha)

MUZEU RAJONAL I MITROVICËS. Muze kompleks i qyteti dhe i rajonit. U themelua në vitin 1952 dhe fillimisht ka qenë i vendosur në ndërtesën e komunës së vjetër. Gjatë viteve 1960-2009 u vendos në Hamamin e Zejnullah Beut, i ndërtuar në kapërcyell të shek. XVIII-XIX, që dikur përbënte pjesë të rëndësishme të qendrës së qytetit të vjetër. Nga viti 2009 muzeu u vendos në objektin e Trupave Mbrojtëse të Kosovës (ish-Shtëpia e Armatës së Jugosllavisë). Muzeu përbëhet nga sektori i arkeologjisë (mbi 1,000 ekspozate), sektori i etnografisë (mbi 800 ekspozate), sektori i historisë dhe sektori i gjeologjisë. (Milot Berisha)

MUZIKA E LEHTË, ARGËTUESE. Emërtim i përgjithshëm për muzikën kryesisht për zë solo dhe orkestër apo ansamble të ndryshme të rinjsh, me përmbajtje rinore, lirike, dashurie apo dhe me karakter vallëzues dhe me përmbajtje të tjera shoqërore. Ekzistojnë festivale të përvitshme me këngë argëtuese, që janë zhvilluar e zhvillohen në vende dhe qendra të ndryshme, në të shumtën e rasteve me karakter garues, ku kanë marrë apo marrin pjesë dhe

janë shpërblyer mjaft kompozitorë, autorë tanë: V. Gjini, S. Gjinali, S. Kajtazi, R. Randobrava, Gj. Kaçinari, M. Piperku, T. Berisha, S. Ballata, Xh. Gashi e të tjerë. Krahas kompozitorëve vepronë dhe interpretët, kantautorët e kësaj gjinie muzikore. Manifestime me këngë të tilla shoqërohen nga orkestra revyale, por edhe orkestra të mëdha simfonike, ansamble të ndryshme instrumentale. Duke qenë muzikë argëtuese dhe përmbajtjet e saj të afërta për një rreth të gjerë dëgjuesish, është përhapur dhe popullarizuar, duke u bërë pjesë e traditës ndër shtresa të gjera shoqërore, sidomos pas Luftës së Dytë Botërore. Këngët e muzikës argëtuese janë të shumta dhe promovohen përmes produksioneve muzikore, si ato të radios, televizionit, përmes festivaleve muzikore etj. Ndër ne, sidomos Radiotelevizioni i Prishtinës është përkujdesur me vite për promovimin e kësaj gjinie muzikore, përfshirë dhe festivalet si “Akordet e Kosovës”, “Zambaku i Prizrenit” etj. Me këtë emërtim të përbashkët përfshihen edhe ato pjesë a miniatura të ndryshme instrumentale muzikore për piano, kitarë etj., që janë me përmbajtje rinore e vallëzuese. (Kristina Palokaj-Perkola)

MUZIKA ELEKTROAKUSTIKE. Kompozohet përmes teknologjisë elektronike, me anë të së cilës gjenerohen, përpunohen, konfigurohen tinguj të organizuar artistikisht që transmetohen me altoparlantë. Termi MEA u përcaktua më 1974 nga kompozitori F. Bayle (kreu i Grupit të Kërkimeve Muzikore, Paris). MEA ka dy zhanre kryesore: Muzikën akuzmatike me artoparlantë dhe ekziston vetëm në formë të regjistruar (në shirit magnetik, kasetë, CD) dhe në muzikën elektronike “live”, ku teknologjia përdoret për të prodhuar, transformuar, kombinuar a prodhuar tinguj gjatë prezentimit. Të dy zhanret varen nga transmetimi përmes altoparlantëve. Mund të përfshijë, pos instrumenteve elektroakustike e gjeneruesve të tjerë, të lidhur me sistemet kompjuterike edhe gjenerimin e tingujve të zërave a instrumenteve tradicionale. Vepra elektro-akustike mund të kombinohet dhe me muzikën e gjallë, me atë akuzmatike. Muzika elektroakustike filloi të zhvillohej në Europë, Japoni, Amerikë në vitet ’50 me kontributin e kompozitorëve Schaefer, Stockhausen, Varese, Xenakis, Boulez, Dallapiccola etj. Shpikja e kompjuterit në vitet ’80 e rriti gamën e

rezultateve, duke thjeshtuar procesin dhe duke hapur mundësinë për çdo kompozitor të jetë lëvrues i saj. Kështu u shndërrua kompjuteri në mjet të rëndësishëm kompozicional. Me zhvillimin e tij dhe programeve kompjuterike, muzika elektroakustike po zë vend gjithnjë më të rëndësishëm. Në Kosovë Donika Rudi është e para që studioi për muzikë elektroakustike dhe shfaqet aktivisht në jetën muzikore në Kosovë e jashtë saj. (Nestor Kraja)

MUZIKA KAMERALE. Është gjini muzikore që kompozohet për grup të vogël a më të madh instrumentistësh. Rastet e para, thuhet, janë paraqitur që në Mesjetë. Por formësimin e rregullt e ka arritur nga klasicizmi i hershëm, për t'u bërë praktikë standarde dhe, pjesërisht, me formacione kamerale të definuara, si: trio harqesh dhe trio pianistike, kuartete harqesh e kuartete pianistike, kuintete harqesh e kuintete pianistike, sekstete, septete, oktete e nonete me përbërje instrumentesh të ndryshme etj. Muzika kamerale në Kosovë i ka fillet pas Luftës së Dytë Botërore. Kompozitorët tanë filluan me përpunime korale mbështetur në muzikën popullore, për të vazhduar me instrumentale, kamerale, orkestrale, vokalo-instrumentale e deri tek ato muzikore-skenike. Kjo u bë e mundshme sidomos me hapjen e institucioneve muzikore në Kosovë, me shkollimin e kompozitorëve brenda dhe jashtë vendit, që krijoi kushte për pasurimin e fondit dhe të produksionit të muzikës artistike. Veprat e para solistike-kamerale i kemi nga R. Mulliqi ("Elegjia", 1955, për violonçel e piano, "Legjenda", 1956, për violinë e piano). Në vitet '60 dalin vepra kamerale nga kompozitorët E. Rizvanolli, F. Beqiri, Z. Ballata e R. Dhomi. Më pas vazhduan dhe të tjerë, duke rezultuar sot me një mori veprash kamerale formacionesh të ndryshme. Muzika jonë tanimë ka një fond të konsiderueshëm veprash të muzikës artistike ndër më të popullarizuarit e këtij lloji, deri te veprat kamerale të kompozitorëve të gjeneratës së tretë dhe asaj të re, që shkrijnë invencionin, duke futur elemente të kohës në këto vepra. Këtu mund të dallojmë: "Bir i vendit trimëror" (1981), "Epitaf N" (1982), "Dialogue" (1982) nga Z. Ballata, Rondo për violonçel e piano (1965) e Rauf Dhomit, deri te Rafet Rudi me veprat "Fantasia in Si" për violinë e piano, (1985). Rëndësia e muzikës kamerale në Kosovë rritet me nismën e festivalit dedikuar

kësaj gjinie muzikore "KamerFest", i themeluar në vitin 2000, i cili tash e pesëmbëdhjetë vjet sjell para publikut artistë e vepra të njohura kamerale. (Rreze Kryeziu-Breznica)

MUZIKA ORKESTRALE. Paraqitet ndër traditat më të vonshme të muzikës shqiptare. Fillimet e saj u përkasin viteve '30 të shek. XX, ndërsa zhvillimet e rëndësishme lidhen me periudhën pas Luftës së Dytë Botërore. Kompozitorët tanë përbëjnë një plejadë krijuesish që u formuan në qendra të ndryshme: SHBA, Itali, Rusi, Çeki, Rumani, Francë, Serbi, Slloveni, Kroaci, Bosnjë e Hercegovinë etj. Veprat orkestrale që themeluan traditën muzikore profesioniste shqiptare janë poemat, rapsoditë, suitat, simfonitë etj. të F. S. Nolit, M. Gjokës, K. Konos, L. Antonit, Ç. Zadesë, R. Mulliqit, N. Zoraqit, T. Harapit, F. Ibrahimit, Z. Ballatës, E. Rizvanollit, R. Dhomit, F. Beqirit, A. Kocit etj. Gjatë viteve 1950-1990 u bënë hapa të rëndësishëm, duke plotësuar vonesën objektive nëpër kohë. Repertori muzikor shqiptar u plotësua me të gjitha format e gjinitë e muzikës orkestrale, si vallet, poemat, rapsoditë, suitat e uverturat orkestrale, koncertet për solist e orkestër, simfonitë, simfonietat etj. Një rol përcaktues për zhvillimin e muzikës orkestrale kanë luajtur, si nëpër botë, edhe në të gjitha trevat shqiptare ngritja dhe organizimi i formacioneve të mëdha muzikore, krijimi i sistemeve të plota të edukimit muzikor. Kështu kanë qenë orkestrat filarmonike a ato simfonike dhe formacione të tjera më të vogla orkestrale, të lidhura me pretendimet e një luajtjeje më të komplikuar e të thelluar instrumentale. Ato kanë ngjallur interesim te kompozitorët dhe kanë mundësuar angazhimin e tyre për të krijuar vepra dimensionesh të mëdha me shprehje të spikatura dramaturgjike. Kjo bëri që veprat orkestrale shqiptare të pësojnë rritje të ndjeshme, sidomos nga gjysma e dytë e viteve '60. Muzika e kësaj periudhe e më tej, në veçanti muzika orkestrale ka një mbështetje në traditën europiane, në folklorin muzikor kombëtar, e ndërldhur edhe me ecuritë bashkëkohore. Përpos kompozitorëve të përmendur më sipër, disa nga figurat e rëndësishme të muzikës orkestrale nga vitet '70 e këtej janë Rafet Rudi, Bashkim Shehu, Thoma Gaqi, Mendi Mengjiqi etj. Muzika kombëtare e gjithë kësaj periudhe, për shkak të rrethanave të ndryshme, përpos arritjesh të caktuara,

e pati më vështirë avancimin e zhvillimeve bashkëkohore siç e patën vendet e tjera më të zhvilluara perëndimore. (Fatmir Hysi)

MUZIKA PËR TEATËR, FILM DHE TV. Është e kompozuar, improvizuar ose e përgatitur për të shoqëruar skena teatrale, sekuenca filmike ose televizive. Në këto raste muzika merr rolin e ilustrueses, shoqërueses ose komentuese. Lidhshmëria e muzikës me teatrin njihet që në lashtësinë greko-romake. Në mesjetë kjo lidhje shfaqet në dramën liturgjike. Në klasicizëm e romantizëm shumë autorë të shquar shkruan muzikë për skena teatrale, proces që vazhdon dhe sot. Shprehje e zhvilluar dhe e rëndësishme e lidhjes së teatrit me muzikën është gjinia e operës. Me lindjen e industrisë kinematografike (fillimi i shek. XX), muzika u përdor për të komentuar në intensitete të ndryshme sekuencat filmike. Në fazën e parë të filmit pa zë u aktivizuan kompozitorë si: Saint-Saëns, Pizetti, Milhaud, Shostakoviç, Hindemith etj. Muzika ekzekutohej nga formacione të vogla apo pianoja gjatë shfaqjes së filmit. Muzika e filmit më pas shfaqej e regjistruar dhe filloi të mishërojë gjendjen emocionale të personazhit a të rrethanës filmike, të shprehë lëvizje a komentojë sekuencën filmike. Sot kompozitorët si H. Zimmer, E. Morricone, J. Newton Howard, J. Adams etj. janë nga më të njohurit në botën kinematografike. Në Kosovë kanë kompozuar për film R. Mulliqi, K. Lekaj, Gj. Gjevelekaj, B. Shehu, R. Dhomi, N. Krasniqi, I. Bajri etj. Ndër krijues shqiptarë të muzikës për film e TV në Los Anxhelos njihet Aldo Shllaku. Muzika në TV zë vend të rëndësishëm, të gjithanshëm, ndërkaq ndarja e krijuesve në kompozitorë të muzikës, dramës, filmit a TV-së është relative. (Nestor Kraja)

MUZIKA SAKRALE. (lat. Musica Sacra, Divina) Është e vjetër aq sa dhe feja e krishterë. Kompozohet për të shprehur besimin individual/kolektiv dhe është pjesë e celebrimeve fetare. Duke qenë gjatë nën sundime të huaja, muzika sakrale te ne nuk është zhvilluar si te popujt e tjerë. Pas Konkilit II të Vatikanit (1963-67), Sinodit iu lejua mbajtja e meshave në gjuhët e popujve. Nga kjo kohë ndër ne ka pasur dhe kontribute: Ipeshkvët imzot Nikë Prela e Dom Rrok Matej botuan përmbledhje këngësh kishtarë në gjuhën shqipe dhe hapën një etapë të re. Dy nga veprat e rëndësishme

për muzikën sakrale në Kosovë janë: “Kantuali kishtar shqiptar” (1974) i përgatitur nga monsinjor N. Mini, botuar në Prizren dhe dy mesha të ndara në 13 kapituj, varësisht prej kremteve e përkushtimeve. Më 1994 u botua në Romë “Libër këngësh korale kishtarë” të kompozitorëve L. Antoni, V. Gjini (pseudonimi Doni) e të tjerë, me tekste të përkthyer nga Dom S. Filipaj, pater H. Kabashi e Dom L. Gjergji. Përmbledhja tjetër “Këndoni Zotit një këngë të re” nga pater H. Kabashi u botua në Gjakovë (1975) me 129 këngë, përkthyer nga gjuhët latine, gjermane, italiane etj. Muzikë kishtarë artistike kanë kompozuar dhe R. Dhomi: dy mesha, këngë për festat e krishtlindjeve dhe të pashkëve, këngët “Alleluja”, “Ave Maria”; A. Koci: disa këngë sakrale: “Nënës së mjerë”, kushtuar Nënë Terezës; Z. Ballata: “Dona Nobis” për kor, fl., glsp e piano, “Nënë Terezë bijë shqiptare”, për recitator e kor, “Nëna Terezë” për soprano e piano, “Hapna sytë tanë”, për soprano, tenor e piano, “Mater Theresiae” për mezosoprano e ansambël, “Pro memoria” 1462, për recitator, solist e orkestër të vogël; Gj. Gjevelekaj: Mesha “Matris Theresiae” për solist, kor e orkestër, mbi vargjet e M. Krasniqit; R. Rudi, dy këngë sakrale që shërbehen tek arbëreshët e Italisë: “O zemra ime ku vete” dhe “Afresk arbëresh”; M. Mengjiqi: oratoriumi sakral “Mater Tereza”, etj. (Rreze Kryeziu-Breznica)

MUZIKA VOKALE-INSTRUMENTALE. Krijimet vokale-instrumentale në Kosovë janë shfaqur rreth viteve '60 të shekullit XX. Veprat e para të këtij lloji ishin të thjeshta, në formacion nevojitej një vokal dhe një orkestër (jo e karakterit simfonik) dhe kënga realizohej. Në kuadër të veprave të kësaj gjinie muzikore hyjnë kantata e oratoriumi, të cilat edhe sot te ne janë pak në numër, për shkak të zotërimit teknik kompozitorial, por edhe për përkushtimin e madh që e kërkojnë. Krijimet e tilla i filloi Rexho Mulliqi (1923-1982). Veprat e para të këtij lloji ishin përpunime dhe stilizime të këngëve popullore si: “Baresha”, “Lulëzoi fusha, lulëzoi mali” (1960) deri te “Poema për ata” (dedikuar minatorëve të Trepçës), kantatë e krijuar në vitin 1961, e konsideruar vepra e parë e këtij lloji në fondin e muzikës artistike në Kosovë. Më shumë vepra vokale-instrumentale kanë lënë kompozitorët e gjeneratës së dytë dhe këtu do përmendur Vinçenc Gjini me kantatat: “Ramiz o vëlla” (1978), “Të duam liri” (1981), “Baladë në


gur” (1982), “Udhëkryqet e jetës” (1985) etj., që trajtojnë tema nga aktualiteti i vështirë i kohës kur janë krijuar. Edhe në kuadër të opusit krijues të Esat Rizvanollit gjejmë vepra të tilla dhe ndër më të rëndësishmet janë: “Fjala e Skënderbeut” (1968) dhe “Rezistenca” 1973. Nga kompozitorët e gjeneratës së tretë dhe asaj të re mund të dallojmë tre prej tyre me vepra të këtij lloji: Zeqirja Ballata me: “Këmbë qëndrese” (1978), “Bir i vendit trimëror” (1981), “Pro Memoria 1462” (1981), “Lacrimosa” (2008), pastaj Rauf Dhomi, në krijimtarinë e të cilit gjejmë dhe kantata, dy të këtij lloji dedikuar edukimit të vajzave dhe hapjes së shkollave të para: “Vatra e urtësisë” (1985) dhe “Uratë vashave” (1990), si dhe Rafet Rudi që mbetet karakteristik në krijimtarinë e tij vokale-instrumentale, nga e cila dallojmë: “Icare ubi es” (1987, një version i ri më 2007), “Flijimi” (1983), “Afresk arbëresh III” (1983), “Fantasia concertante” (2012), më të cilën fitoi çmimin e parë nga Ministria e Kulturës e Republikës së Kosovës. Vend të rëndësishëm në krijimtarinë e këtij lloji zë vepra vokale-instrumentale e kompozitorit Mendi Mengjiqi, “Homagium Matri Teresiae” (1999), oratorium i parë, deri sot i vetëm në Kosovë. (Rreze Kryeziu-Breznica)

MYFTARI Agon (1985-). Regjisor. Lindi në Prishtinë. Shkollimin fillor dhe të mesëm i kreu në Prishtinë, studimet për regji teatri në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës (2008). Në Teatrin Kombëtar të Kosovës bëri regjinë e shfaqjeve “Dejzilend” (2009) dhe “39 shkallët” (2013). Me Kompaninë teatrore “Moissi” inskenoi shfaqjet “Emigrantët” (2009) në Teatrin “Oda”, pastaj “Shtatë maskat e bardha” (2011) në Teatrin “Dodona” dhe “Duke pritur Godonë” (2010) në Teatrin “Adriana” të Ferizajt. Me kompaninë teatrore “La Rremë”, në Teatrin “Oda” ka vënë në skenë shfaqjen “Sikur kjo të ishte shfaqje” (2012), ndërkaq në Teatrin e Prizrenit shfaqjen “Vigilje” (2015). Në Teatrin Shqiptar të Shkupit punoi shfaqjen për fëmijë “Imagjinatorët” (2011) dhe shfaqjen “Gishti” (2013). Në Qendrën Teatrore për Fëmijë në Shkup ka vënë në skenë shfaqjen për fëmijë “Magjistari nga Ozi” (2014). (Erson Zymberi)

MYFTARI Emrush (1910-1945). Veprimtar për çlirimin kombëtar të shqiptarëve në ish-Jugosllavi, antifashist, luftëtar i Spanjës. Lindi në Pejë. Kreu Liceun Kombëtar (francez) në

Korçë dhe shkollën ushtarake mbretërore në Tiranë. Ishte në mesin e të rinjve vullnetarë antifashistë shqiptarë që shkuan në Spanjë, për të luftuar në mbrojtje të Republikës. Gjatë viteve të Luftës së Dytë Botërore mbajti qëndrim antifashist dhe angazhohej për bashkimin e trojeve etnike shqiptare. Më 1943 ngriti zërin kundër Masakrës së Bihorit. U angazhua për zbatimin e vendimeve të Konferencës së Bujanit. Në fund të Luftës, për shkak të pikëpamjeve të tij për zgjidhjen e problemit kombëtar të shqiptarëve në Jugosllavi, u vu nën mbikëqyrjen e OZN-ës. U arrestua në vjeshtën e vitit 1944 dhe u pushkatua nën akuzën si agjent i shërbimit anglez. (Fehmi Rexhepi)

MYFTARI Hazir (1948-2014). Aktor. Lindi në Vushtri. Studimet për aktrim i kreu në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prishtinë (1969), kur edhe filloi punën si aktor në Teatrin Popullor Kra-



HAZIR MYFTARI

hinor. Realizoi një sërë rolesh në shfaqjet: “Gjenerali i ushtrisë së vdekur” të P. Manit (1973), “Emigrantët” e M. Georkijevit (1977), “Ana Karenina” e E. Radomisenki (1979), “Trungu Ilir” (1981) dhe “Gjon Nikollë Kazazi” (1983) në regji të Agim Sopit, “Bregu i Pikëllimit” e V. Milçinit (1987), “Shfaqja e fundit” (2001) dhe “Lidhje gjaku” (2010) të F. Hysajt. Shfaqja “Lidhje gjaku” ishte shfaqja e tij e fundit, me të cilin shënoi edhe 40-vjetorin e karrierës. Pos në teatër, H. Myftari realizoi një numër rolesh edhe në filma artistikë, si: “Tre veta kapërcejnë malin” të B. Sahatçiu, “Proka” të I. Qosjes, si dhe role të tjera në filmat “Njeriu prej dheu”, “Kur pranvera vonohet”, “Përroi vërshues”, “Lepuri me pesë këmbë”, “Etjet e Kosovës”, dhe në serialet televizive: “Era dhe Lisi”, “Pasqyra”, “Migjeni”, “Rrëfime nga gjyqi” etj. Në periudhën 1981-1989 ishte drejtor Teatrit Popullor Krahinor. Gjatë vitit 1981-83 ishte kryetar i Këshillit të Festivalit të Filmit Jugosllav në Pulë. Për punën në teatër dhe film u nderua me çmime dhe mirënjohje. (Fadil Hysaj)

MYRTAJ Malë (1953-). Skulptor. Lindi në Pejë. Kreu Shkollën e Mesme të Artit në Pejë, ndërsa studimet për skulpturë në Akademinë e Arteve në Prishtinë (1978). Punoi si mësimdhënës në gjimnazin “Skenderbeu” në Preshevë (1978-

1981) dhe në Shkollën e Mesme të Artit në Pejë (1982-1989). Është anëtar i Shoqatës së Artistëve Figurativë të Kosovës nga viti 1978 dhe anëtar i Shoqatës së Artistëve Figurativë në Singen të Gjermanisë nga viti 2007, pastaj në Shoqatën e Artistëve Figurativë në Uberlingen po në Gjermani nga viti 2008. Është fitues i disa çmimeve dhe i mirënjohjeve, si: “Dorëza e artë” për Kampionatin Botëror të Boksit Amator, Beograd (1978), çmimi i parë në konkursin federativ në ish-Jugosllavi për Stafetën e Rinisë (1978), Mirënjohje e Bionalës së Plastikës së Vogël në Lubjanë etj (1979) etj. Ka marrë pjesë në shumë ekspozita kolektive në ish-Jugosllavi, Kosovë, Gjermani, Zvicër dhe Francë dhe ka hapur ekspozita personale në Kosovë dhe në disa qendrat europiane. Nga viti 1989 jeton dhe vepron në Singen të Gjermanisë. (Agim Rudi)


MYRTEZAI Masar (1924-2001). Gazetar, përkthyes. Lindi në Gjakovë. Filloren e mbaroi në vendlindje. Regjistroi Shkollën qytetare në Gjakovë dhe më pastaj Medresenë në Shkup. Më 1942 kalon në Prishtinë, në Shkollën Normale “Sami Frashëri”. Punoi mësues në Junik e pastaj në Prizren. Më 1946 emërohet kryeredaktor i “Gazetës së pionierëve”. Për shumë vjet ishte kryeredaktor i revistës “Zani i rinisë shqiptare”, përkatësisht “Zani i rinisë”, kur redaksia ndodhej në Beograd

dhe më pas në Prishtinë. Studioi për gazetari dhe diplomaci dhe, së fundi, për gjeografi-histori në Fakultetin e Shkencave Natyrore të Universitetit të Beogradit. Pas përfundimit të studimeve (1955) u kthye në Prishtinë, fillimisht si redaktor e pastaj si zëvendëskryeredaktor i “Rilindjes”. Në këtë gazetë udhëhoqi rubrikën e kulturës, faqen e fëmijëve, rubrikën e politikës së jashtme dhe atë të humorit. Më 1967 kaloi në TV Prishtina, redaktor dhe kryeredaktor, kurse nga viti 1974 e deri më 1984 ishte shëf i kabinetit të Fadil Hoxhës në Beograd. Përktheu disa vepra letrare. (Zenun Çelaj)

MYZEQINA. Fshat në komunën e Shtimes, 4 km në verilindje të qytezës. Është fshat fushor i tipit të grumbulluar. Territori i fshatit ka sipërfaqe prej 6 km². Me këtë emër për herë të parë përmendet në defterin kadastral të vilajetit Vëllk të vitit 1455. Popullsia e fshatit është e ardhur kryesisht nga Sazlia dhe Jezerci. Ka edhe muhaxhirë të ardhur nga sanxhaku i Nishit. Në vitin 2011 fshati kishte 1,324 banorë, ndaj 729 banorëve sa kishte në vitin 1948. Popullsia merret kryesisht me bujqësi. Është seli e bashkësisë lokale për vendbanimet Rashincë, Vojnoc dhe Gjurkoc. Ka shkollën 9-vjeçare, qendrën e mjekësisë familjare, disa njësi tregtare etj. (Shpend Agaj)

N

NAHI Faik (1942-). Inxhinier i energjetikës. Lindi në Gjakovë, shkollimin fillor dhe të mesëm i kreu në vendlindje, ndërsa studimet në Fakultetin Elektroteknik të Universitetit të



FAIK NAHI

Zagrebit (1965). Filloi punën në kombinatin “Kosova”, ku u bë bartës i projektit të gazifikimit të thëngjillit dhe të industrisë kimike të kësaj ndërmarrjeje. Menaxhoi disa projekte të rëndësishme në Termocentralin “Kosova A” dhe udhëhoqi projektin e Termocentralit “Kosova B” (1981-1990). Ishte udhëheqës i sektorit për zhvillim strategjik të Korporatës Energjetike të Kosovës. Hartoi disa studime në fushën e energjisë së ripërtëritshme (hidrocentrale të vogla) dhe në fushën e efijencës dhe të menaxhimit të konsumit energjetik. Në periudhën 2008-2011 ishte këshilltar kryesor për energji në Ministrinë e Energjisë dhe të Minierave. Në vitet 1976-1986 ishte ligjërues në FE të Universitetit të Prishtinës. (Isuf Krasniqi).

NAHI Myderriz Hasan (1905-1991). Teolog islam, përkthyes i Kuranit, veteran i arsimit. Lindi në Gjakovë, ku mori mësimet e para dhe kreu medresenë. Mbaroi studimet në Universitetin “Al-Azhar” të Kajros, në Fakultetin “Kismi Ali” (1934). Pas përfundimit të studimeve, Ulema Mexhlisi në Shkup e emëroi në detyrën “ligjërues terreni” (1935), ku qëndroi për tri vjet dhe u shqua për mënyrën e shpjegimit dhe të komentimit të mësimëve të fesë islame. Më 1938 mori detyrën e myderrizit në Medresenë e Ferizajt, ku filloi ligjërimin e mësimëve në gjuhën shqipe. Më 1943 Komuniteti Mysliman Shqiptar në Tiranë

e emëroi kryemyfti të zonës së Dukagjinit, si dhe myderriz kryesor e drejtues të Medresesë “Mehmed Pasha” në Prizren. Në vitin 1958 u caktua mësimdhënës për lëndën e Kuranit dhe i lëndëve të tjera fetare në Medresenë “Alaudin” në Prishtinë, ku punoi deri në pension (1978). Në vitin 1988 botoi Kuranin e përkthyer në gjuhën shqipe. (Ramadan Shkodra)


NAHTIGAL Rajko (1877-1958). Gjuhëtar sloven. Studioi sllavistikë në Vjenë. Ishte profesor në Universitetin e Gracit dhe të Lubjanës, dekan i Fakultetit Filozofik në Lubjanë dhe rektor i Universitetit të Lubjanës.



RAJKO NAHTIGAL

U zgjodh anëtar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Sllovenisë më 1938 dhe ishte kryetar i parë i saj (1939-1942). U mor edhe me studime për gjuhën shqipe. Ishte i ftuar nga Komisija Letrare e Shkodrës që të bënte ekspeditë hulumtuese në Elbasan, tok me Gjergj Pekmezit e Ndre Mjedën, për nevoja të krijimit të një shqipe të njësuar me bazë elbasanishten. Botoi studime për alfabetin e Elbasanit. Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Sllovenisë, botoi më 2015 përmbledhjen “Për një gjuhë të përbashkët letrare shqipe”, ku përfshihen të gjitha studimet e R. Nahtigalit për shqipen. (Lindita Rugova)

NOJDEK (Neudeck) Rupert (1939-2016). Aktivist për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, themelues i organizatës humanitare “Cap Anamur”. Lindi në Danzing (Gdanjsk) të Polonisë. Studioi për drejtësi dhe teologji



RUPERT NOJDEK

katolike, ndërsa më vonë për filozofi dhe shkencë politike. Një kohë punoi si gazetar. Në vitin 1979 u bë i njohur, kur organizata e tij ua shpëtoi jetën 11,000 vietnamezëve në Detin Jugor të Kinës. Në shtator të vitit 1998 R. Nojdek e dorëzoi postin

e kryesuesit të “Cap Anamurit”, por u kthye sërish për t’u angazhuar në Kosovë. Në vitet 1998-1999 ishte aktiv në sistemimin e shqiptarëve të Kosovës të dëbuar me dhunë nga regjimi i Beogradit. Sipas të dhënave të “Cap Anamur”, organizata mblodhi mbi 58,7 milionë marka gjermane për kosovarët. Ishte i njohur angazhimi i tij për Kosovën edhe pas luftës. “Cap Anamur” ndërtoi rreth 6,000 shtëpi në 75 fshatra, nëntë shkolla fillore, pesë shkolla profesionale dhe një spital. Për punën e tij humanitare u nderua me shumë mirënjohje dhe çmime. Në shkurt të vitit 2016, disa muaj para vdekjes, u nderua me medaljen “Nënë Tereza” nga presidentja e Kosovës. (Valdrin Ukshini)

NAISI. Vendbanim antik te Nishi (Serbi). Shtrihej në të djathtë të lumit Nishava, në kryqëzim të rrugëve transballkanike. Figuroi në të gjitha itineraret romake, si Tab. Peut. Segm. VII; Itin. Ant., 134; Itin. Hieros. 566. 3; Geogr. Rav., IV, 7. U njoh nga burimet antike si “oppidum”, “civitas” dhe “urb”. Rëndësia e tij para pushtimit romak njihet pak dhe për herë të parë përmendet në veprën “Gjeografia” të Ptolemeut (shek. II), i cili e radhit në mesin e qyteteve më të mëdha dardane. Në gjysmën e dytë të shek. II u ngrit në rang municipi dhe u bë qendër e rëndësishme ekonomike, ushtarake dhe administrative. Në territorin e tij u vendosën njësitë ushtarake romake Cilicum I, Cretum I, Flavia IV, Claudia VII dhe Aurelia Dardanorum I. Njihet si vendlindja e perandorit Konstantini i Madh, gjatë sundimit të të cilit qyteti e arriti kulmin e lulëzimit. Njihet edhe si qendër episkopale, ipeshkvijë të së cilës luajtën rol të rëndësishëm në dallimet eklesiastike, sidomos të shek. IV. Gjatë shek. VI-X u pushtua përkohësisht nga hunët, avarët, sllavët dhe bullgarët. (Arben Hajdari)

NAJDENI Sait (1864-1903). Rilindës, veprimtar i arsimit. Lindi në qytetin e Dibrës, ku kreu

shkollën fillore (iptidaije) dhe gjimnazin e ulët (ruzhdiqe). Vazhdoi studimet teologjike në Medresenë e Fatihut në Stamboll, të cilat i përfundoi në vitin 1888. Pas studimeve, me libra shqip nga Stambolli, u kthye në vendlindje, ku formoi një shoqëri atdhetare për përhapjen e arsimit dhe të lëvizjes kombëtare. Po në vitin 1888, në shtëpinë e tij hapi një shkollë shqipe, por pas një viti autoritet osmanë e mbyllën. S. Najdeni (Hoxhë Voka), u mor edhe me punë krijuese. La të botuara veprat: “Fe-Rrëfenjësja e myslimanëve” (1900), me 64 faqe dhe “Abetare e gjuhës shqipe”, në të “folmen gegënisht” (1900), me 16 faqe. Kjo abetare, pas vdekjes së tij, u ribotua edhe tri herë. (Xheladin Murati)

NALLBANI Latif (1940-). Gazetar. Lindi në Kaçanik. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, shkollën normale në Prishtinë e Shkup, ndërsa studimet për gjuhë dhe letërsisë shqipe në Fakultetin Filozofik të Prishtinës. Punoi mësues në fshatin Çellopek të Tetovës (1958/59), pastaj në Han të Elezit dhe Kaçanik. Që i ri bashkëpunon me Radio Prishtinën dhe gazetën “Rilindja”. Një kohë ishte korrespondent nga komuna e Kaçanikut për gazetën “Rilindja”. Në Entin Ndërkomunal Pedagogjik në Ferizaj punoi nga viti 1966, pastaj në Entin Pedagogjik të Prishtinës. Bashkëpunoi edhe me revistat që u botuan në Prishtinë, kryesisht me tema nga fusha e arsimit. Deri në pension ishte gazetar dhe redaktor i revistës për arsim “Shkëndija”. (Ibrahim Berisha)

NAMANI Abdyl (1937-). Inxhinier i makinerisë. Lindi në Nedakoc, Vushtrri. Shkollën fillore e kreu në Vushtrri, ndërsa gjimnazin në Mitrovicë. Mbaroi studimet në Fakultetin e Makinerisë të Universitetit të Zagrebit (1968). Punoi në shkollën teknike “19 Nëntori” në Prishtinë dhe në NGBG “Rilindja”. Nga viti 1971 e deri në pension punoi në Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK), në Termocentralin “Kosova A” në Obiliq, ku ishte udhëheqës në shumë njësi punuese. Specializoi për turbina me avull në Bërno të Çekisë dhe ishte në perfeksionim profesional në Gjermani, Hungari, Ukrainë. Nga viti 1972 punoi si pedagog i angazhuar në Fakultetin Teknik të Universitetit të Prishtinës për lëndën gjeometria deskriptive. Mori pjesë në simpoziume profesionale-shkencore, ku janë trajtuar problematikat e energjetikës. Ka bërë përkthimin e disa teksteve shkollorë. (Fehmi Krasniqi).

NASALCA. Vendbanim rural i tipit të dendur, 8 kilometra në jugperëndim të Bujanocit. Shtrihet në lartësinë mbidetare 430-470 m, në kontaktin e relievit kodrinor të zonës së Karadakut në perëndim dhe fushës së Preshevës në lindje. Sipërfaqja e territorit të fshatit është 1,466 ha. Objektet e banimit janë ndërtuar në të dy anët e rrugës regjionale Miratoc-Lluçan. Në vitin 1961, Nasalca kishte 1,081 banorë, ndërsa në vitin 2002 kishte 1,831 banorë rezidentë. Popullsia merret kryesisht me bujqësi, por një numër i konsiderueshëm i familjeve jeton nga remitancat e mërgimtarëve në botën e jashtme. Ka shkollën tetëvjeçare dhe ndonjë objekt tjetër të standardit shoqëror. (Arsim Ejupi)

NASI Lefter (1948-2007). Historian. Lindi në Hoshtovë të Zagorisë. Më 1950 familja e tij u vendos në Tiranë, ku kreu arsimin fillor dhe të mesëm dhe studimet në degën histori-gjeografi në Universitetin e Tiranës. Punoi në Institutin e Studimeve Pedagogjike dhe njëherësh pedagog i jashtëm në Fakultetin e Historisë e Filologjisë të Universitetit të Tiranës. Më 1979 punësohet në sektorin e historisë së Kosovës në Institutin e Historisë në Tiranë, ndërsa në periudhën 1989-1994 ishte zëvendës drejtor i Institutit të Historisë. Nga viti 1994 e deri në fund të jetës punoi si sekretar shkencor i seksionit të shkencave shoqërore dhe albanologjike në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë. U mor me studime të historisë të kohës së re. Botoi vepra shkencore dhe artikuj të shumtë brenda dhe jashtë vendit. Është autor i monografive “Ripushtimi i Kosovës” (1994), “Aspekte të shtypjes kombëtare e politike të shqiptarëve në Kosovë (1981-1986)” (1995) etj., pastaj bashkëredaktor i vëllimeve: “E vërteta për Kosovën dhe shqiptarët në Jugosllavi” (1990) dhe “Kosova një problem historik dhe aktual” (1995). Ishte anëtar i redaksive të disa revistave shkencore, mori pjesë me referate e kumtesa në disa konferenca shkencore të rëndësishme. (Frashër Demaj)

NASUFI Vahit (1945-). Shkrimtar. Lindi në Veleshtë të Strugës (Maqedoni), në një familje punëtore-kurbetqare. Kreu shkollën fillore në vendlindje, Normalen dhe Shkollën e Lartë Pedagogjike në Shkup. Me shkrime merret që nga shkolla fillore. Shkruan kryesisht poezi dhe prozë për fëmijë. Bashkëpunon me të gjitha

gazetat dhe revistat letrare në gjuhën shqipe. Deri tash botoi këto përmbledhje me poezi për fëmijë “Valët e Drinit” (1980), “Dallëndyshja dhe lisi” (1984), “Kush ëndërron më bukur” (1985), “E kam shok bilbilin” (1987), “Koha e xixëllonjave” (1987), “Heshtja e gurit” (1994), “Gjyshja i numëron yjet” (1996) etj. (Xhevat Sylja)

NATO (North Atlantic Treaty Organisation - Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut) Organizatë politiko-ushtarake e vendeve të Europës dhe të Amerikës Veriore e themeluar më 4 prill 1949 me qendër në Bruksel. Traktati u nënshkrua nga 10 vende: Belgjika, Danimarka, Franca, Britania e Madhe, Islanda, Italia, Luksemburgu, Holanda, Norvegjia, Portugalia, Kanadaja dhe SHBA-ja. Më vonë në këtë organizatë u anëtarësuan edhe Greqia dhe Turqia (1952), Gjermania (1955), Spanja (1982), Çekia, Hungaria dhe Polonia (1999), pastaj më 2004 NATO-s iu bashkuan edhe Estonia, Lituania, Letonia, Bullgaria, Rumania, Sllovakia dhe Sllovenia, ndërsa më 2009 u anëtarësuan Shqipëria dhe Kroacia. Qëllimi kryesor i anëtarëve themelues ishte që t'i kundërviheshin rrezikut të zgjerimit të ndikimit të Bashkimit Sovjetik në Europë. Me nënshkrimin e këtij Traktati, anëtarët përkushtoheshin për të mbrojtur në mënyrë të ndërsjellë lirinë dhe sigurinë e tyre me anën e mjeteve politike e ushtarake. NATO-ja është një organizatë ndërqeveritare, një aleancë shtetesh sovraane, e bashkuar në emër të sigurisë dhe vlerave të përbashkëta. NATO-ja merr vendime duke u mbështetur në parimin e konsensusit. Zyrat Qendrore të NATO-s ndodhen në Bruksel. Atje ndodhet selia e përhershme e Këshillit të Atlantikut të Veriut (NAC). Në të bëjnë pjesë delegacionet kombëtare të shteteve anëtare, Sekretari i Përgjithshëm dhe Shtabi Ndërkombëtar, Kryetari i Komitetit Ushtarak dhe Shtabi Ushtarak Ndërkombëtar, misionet diplomatike të shteteve partnere dhe agjenci të ndryshme të NATO-s. Shtetet anëtare kanë delegacione të përhershme në Zyrat Qendrore të NATO-s, që udhëhiqen nga krerët e misionëve. Çdo shtet anëtar përfaqësohet edhe nga një delegat ushtarak. Përfaqësuesi i përhershëm, ashtu si edhe ushtarakët, ndihmohen për kryerjen e detyrave të tyre nga një grup këshilltarësh e oficerësh civilë e ushtarakë, të cilët përfaqësojnë vendin përkatës në secilin prej Komiteteve të NATO-s.

Institucionet kryesore drejtuese të NATO-s janë: Këshilli i Atlantikut Verior (NAC), Komiteti i Planifikimit të Mbrojtjes (DPC) dhe Grupi i Planifikimit Bërthamor (NPG). Këshilli i Atlantikut Verior është njësi vendimmarrëse me rëndësi vendimtare për Aleancën. Janë dy komanda ushtarake të NATO-s, të cilat kanë rëndësi strategjike: njëra është Komanda Supreme e Aleatëve për Europën (SACEUR), e cila e ka selinë e vet në Mons të Belgjikës, ndërsa tjetra është Komanda Supreme e Aleatëve për Shndërrimin (SACT), e cila e ka selinë në Norfolk të shtetit Virginia të SHBA-së. Asambleja parlamentare e NATO-s, e njohur si Asambleja e Atlantikut Verior, është një organizatë ndërparlamentare e krijuar në vitin 1955, si forum që bashkon ligjvënësit e vendeve anëtare, për të diskutuar çështje me interes të përbashkët. NATO-ja ka ndërhyrë ushtarakisht për të ndaluar apo parandaluar konflikte në tri raste: në Bosnjë dhe Hercegovinë në 1995, në Kosovë më 24 mars 1999 dhe në Republikën ish-Jugosllave të Maqedonisë në 2001. Së fundi udhëheq dy misione paqeruajtëse: Forcën e Stabilizimit (SFOR) në Bosnjë e Hercegovinë dhe Forcën e Kosovës (KFOR). (Sylë Ukshini)

NAVAKAZI Vlorë (1962-). Inxhinieri e arkitekturës, mësimdhënëse universitare. Lindi në Prishtinë, ku kreu shkollimin fillor dhe të mesëm. Kreu studimet për arkitekturë në



VLORË NAVAKAZI

Fakultetin e Ndërtimitarisë dhe të Arkitekturës në UP (1985). Studimet pasuniversitare dhe të doktoratës i kreu në Universitetin e Sarajevës (2012). U zgjodh asistent (1985), më pas profesor asistent në Fakultetin e Ndërtimitarisë dhe të Arkitekturës në UP (2015). Ka botuar disa punime shkencore me recension ndërkombëtar rreth çështjeve urbane dhe arkitektonike të Kosovës në periudhën osmane. Për punën profesionale mori çmime në konkurse të ndryshme arkitektonike dhe urbane: shkolla e mesme “Xhevdet Doda” në Prishtinë, teatri dhe opera “Ibrahim Rugova” në Prishtinë, lumi Mirusha në Gjilan, si dhe planet urbane në Prizren për planin rregullues “Arbëria 3” etj. (Dervish Qerreti).

NDËRHYRJA E NATO-S NË KOSOVË (24 mars - 10 qershor 1999). Fushata ajrore e NATO-s kundër çaqeve ushtarake, policore dhe paramilitare serbe në Kosovë, në Serbi dhe në



HYRJA E TRUPAVE TË NATO-S NË KOSOVË (10 QERSHOR 1999)

Mal të Zi. Sulmet ajrore të NATO-s filluan më 24 mars 1999 dhe zgjatën 78 ditë, duke rezultuar me tërheqjen e plotë të të gjitha trupave ushtarake, policore dhe paramilitare serbe dhe vendosjen e administrimit ndërkombëtar në Kosovë. Me të filluar sulmet ajrore, në shenjë hakmarrjeje, forcat serbe intensifikuan dhunën, vrasjet masive dhe deportimin e shqiptarëve të Kosovës. Ishte hera e parë në historinë e NATO-s që goditej ushtarakisht një shtet, pa pasur mandatin paraprak të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Prandaj fushata e bombardimeve të NATO-së ndaj Jugosllavisë së mbetur hapi debat në lidhje me legalitetin, shkaqet dhe qëllimet e luftës, efektivitetin e fushatës, si dhe çështjet e tjera që lidheshin me promovimin e një doktrine të re ushtarake dhe me krimin e një rendi të ri ndërkombëtar. Fushata e bombardimeve mbi çaqet ushtarake serbe kishte për qëllim t'i dëshmonte Millosheviqit se Perëndimi ishte i vendosur për ndalimin e spastrimeve etnike, për të penguar realizimin e planeve për dëbimin dhe për vrasjen masive të civilëve shqiptarë (“Operacioni Patkoi”) dhe për të goditur aftësinë vepruese të kapaciteteve ushtarake të ushtrisë dhe të policisë serbe. NATO-ja përfundimisht i kishte përkufizuar

qëllimet e veta në mënyrë koherente më 12 prill 1999, në një mbledhje të jashtëzakonshme të Këshillit të Atlantikut të Veriut. Kërkesat që i drejtoheshin Beogradit përfshinin: ndërprerjen e të gjitha aktiviteteve ushtarake, të dhunës e të represionit të RFJ-së/Serbisë në Kosovë, lejimin e vendosjes së paqeruajtësve ndërkombëtarë në Kosovë, mospengimin e kthimit të pakushtëzuar dhe të sigurt të refugjatëve dhe të personave të zhvendosur dhe vendosja e papenguar e organizatave humanitare në Kosovë, si dhe shprehja e gatishmërisë për të gjetur një zgjidhje politike për Kosovën në bazë të Planit të Rambujesë, të mbështetur në të drejtën ndërkombëtare dhe në Kartën e OKB-së. Operacionet ajrore të NATO-s ishin të ndara në faza të ndryshme. Përmes intensifikimit shkallë-shkallë do të duhej të garantohet fleksibiliteti politik dhe aftësia reaguese në shkallët e ndryshme të zhvillimit të një konflikti. Faza 0 (zero) e operacioneve ajrore përbante transferimin e forcave ajrore nëpër aeroporte, nga të cilat mund të arrihej territori i Jugosllavisë së mbetur. Përveç kësaj, përfshiheshin fluturimet për kontrollimin e hapësirës ajrore mbi Jugosllavinë e mbetur, por pa hyrë në hapësirën ajrore. Në rast se Milloseviqi nuk lëshonte pe përballë këtyre masave, do të pasonte faza 1 me operacione ajrore për zbatimin e zonës së ndalimfluturimit dhe për të arritur “epërsi ajrore” mbi Jugosllavinë e mbetur dhe për “sundim ajror” mbi Kosovë. Përveç kësaj, do të sulmohej ose do të vihej nën trysni elektronike mbrojtja kundërajrore jugosllave dhe do të bombardoheshin aeroportet dhe linjat e komunikacionit të ushtrisë serbe në Kosovë. Përkrah vazhdimin e masave të fazës 1, faza 2 do të zgjerohet me sulme në territorin e Jugosllavisë së mbetur në jug të paraleles 44 gjeografike dhe do të drejtohej kundër përforsimeve dhe linjave për trupat serbe në Kosovë, si dhe kundër kazermave, shtabeve të përgjithshme etj. Faza e 2-të e planifikimit të NATO-s parashihte vazhdimin e masave nga faza 1 e 2, zgjerimin e tyre në tërë territorin e Jugosllavisë së mbetur dhe përfshirjen e caqeve strategjike dhe taktike. Në këtë fazë duhej të sulmoheshin shtabet e përgjithshme ushtarake, si dhe vendet prodhuese dhe rezervat. Të gjitha këto masa dhe fazat e tyre kundër armatës serbe synonin të kufizonin mundësinë për përndjekjen, për vrasjen dhe për dëbimin e shqiptarëve të Kosovës dhe njëkohësisht duke mbajtur të hapur rrugën e zgjidhjes politike.

Me nënshkrimin e Marrëveshjes Tekniko-Ushtarake të Kumanovës (9 qershor 1999), de facto Serbia pranoi humbjen e luftës dhe nga ky moment filloi tërheqja e plotë e forcave ushtarake dhe policore serbe nga Kosova. Këshilli i NATO-s, natën mes 9 dhe 10 qershorit 1999, e pranoi Marrëveshjen Tekniko-Ushtarake të nënshkruar nga gjenerali britanik i NATO-s, Majk Xhekson. Sipas Këshillit, Marrëveshja e Kumanovës përbante të gjitha kërkesat e vendosura nga bashkësia ndërkombëtare: armëpushimin, largimin e policisë dhe ushtrisë serbe nga Kosova, vendosjen e trupave ushtarake të NATO-s në Kosovë, kthimin e papenguar e të dëbuarve dhe, pas një periudhe të administrimit ndërkombëtar do të adresohet statusi politik i Kosovës. Serbia i pranoi kushtet e NATO-s dhe ajo filloi tërheqjen nga Kosova. Po me këtë rast gjenerali Klark suspendoi përkohësisht sulmet ajrore. Forcat ruse hynë në Prishtinë dhe po me atë radhë u dislokuan në Aeroportin e Prishtinës. Më 11 qershor në Kosovë u dislokuan forcat e NATO-s (KFOR), ndërsa më 12 qershor trupat britanike hynë në Prishtinë. Më 20 qershor trupat dhe policët e fundit serbë u larguan nga Kosova dhe NATO-ja e ndali edhe zyrtarisht operacionin ajror. Me këtë datë zyrtarisht mori fund lufta e Kosovës. (Sylë Ukshini)

NDËRMARRJET AFARISTE INDIVIDUALE. Janë ndërmarrjet e regjistruara apo të paregjistruar, të cilat ushtrojnë aktivitet afarist të pandarë nga pronari i vet. Sipas ligjit në fuqi në Kosovë pronari i ndërmarrjes individuale afariste është përgjegjës pa kufizim për të gjitha detyrimet e ndërmarrjes ndaj palëve të treta dhe përgjigjet për këto detyrime personalisht. Ligji përcakton se ndërmarrja afariste individuale nuk është person juridik. Pra, sipas ligjit parashihet që ndërmarrja afariste individuale mund të lidhë kontratë, të posedojë pronë, të ushtrojë padi dhe të jetë e paditur në emrin e vet apo të pronarit. Ndonëse kjo formë e ushtrimit të veprimtarisë afariste është e përshtatshme për mikrobiznese individuale, në Kosovë kjo formë e ushtrimit të veprimtarisë afariste mund të haset edhe te bizneset me një qarkullim më të madh financiar. (Dastid Pallaska)

NDËRMARRJET E VOGLA DHE TË MESME. Organizata që punësojnë një numër të caktuar të punëtorëve, më së shpeshti deri në

250, sipas kritereve të Bashkimit Europian. Ky kriter është aprovuar edhe me ligjin për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në Kosovë. Këto organizata kanë një rol ekonomik dhe social shumë të rëndësishëm, për shkak të kontributit të tyre në gjenerimin e inovacionit, në rritjen ekonomike dhe në krijimin e vendeve të punës. Kontributi i tyre është shumë i vlefshëm në kushtet e krizës dhe të rritjes së papunësisë. Ngjashëm si në BE, ashtu edhe në Kosovë, mbi 99% e ndërmarrjeve janë ndërmarrje të vogla dhe të mesme, nga të cilat mbi 98% të tyre punësojnë më pak se 10 punonjës. Bizneset individuale në mënyrë të qartë dominojnë strukturën pronësore me 90%. Pjesa tjetër e kompanive janë ortakëri e përgjithshme (3.2%) dhe shoqëri me përgjegjësi të kufizuara (5.8%). Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në Kosovë kryesisht operojnë në fushën e tregtisë dhe të shërbimeve dhe më pak në atë të prodhimit. Ndonëse kanë kontribuar në ekonomi, këto ndërmarrje ballafaqohen me pengesa të ndryshme, për ç'arsye nuk janë aq konkurrense në nivel ndërkombëtar, janë eksportuese të dobëta dhe nuk ndihmojnë rritjen e shpejtë ekonomike. Për t'i tejkaluar këto probleme, Qeveria e Kosovës ka miratuar një strategji për zhvillimin e këtyre ndërmarrjeve. (Besnik Krasniqi)

NDOCI Naxhi (1933-). Dramaturg, shkrimtar, gazetar, kritik arti. Lindi në Shkup. Shkollën fillore, të mesme dhe studimet e larta të albanologjisë i kreu po në Shkup. Për shumë vjet ishte gazetar në gazetën "Flaka e vëllazërimit". Veprimtarinë letrare e nisi me dramën "Dashuria pa fat", pastaj shkroi njëaktëshen për fëmijë "Agroni" dhe më pas rreth 20 tregime që u botuan në gazetën "Rilindja", në revistën letrare "Jehona" etj. U mor me kritikë teatrore, përfshirë shkrime kritike për realizimet skenike të teatrove të Kosovës. Një pjesë të shkrimeve për teatër i ka përmbledhur në librin "Shikime nga skena", kushtuar veprimtarisë skenike të dramës shqipe të Teatrit të Kombësive në Shkup. Ndërkohë ka botuar dramat: "Ndërmjet dy fatkeqësive", "Perandori tha", "Në krye të urës", "Dielli lind edhe për ne", "Konstantini i Madh", "Mbreti Longar", si dhe romanet: "Ajo qeshi vetëm një verë", "Gexhek-ondu", "Rrënjët" etj. (Emin Emini)

NDOJA Zef (1942-). Lindi në fshatin Bec, komuna e Gjakovës, shkollën fillore e kreu në vendlindje dhe Cermjan, të mesmen bujqësore në Svillajnac. Studimet për bujqësi nga teknologjia e pemëve dhe e perimeve i kreu në Fakultetin e Bujqësisë të Universitetit të Beogradit (1968). Studimet pasuniversitare dhe tezën e disertacionin e mbrojti në Fakultetin e Bioteknologjisë të Universitetit të Zagrebit (1988). Zgjidhet asistent në Fakultetin e Bujqësisë të Universitetit të Prishtinës për lëndën mikrobiologjia, pastaj zgjidhet docent për lëndën teknologjia e prodhimeve blegtorale dhe më vonë merr edhe titujt e tjerë po për këtë lëndë. Ka botuar një numër punimesh shkencore dhe profesionale në revista që botohen në vend dhe në botën e jashtme. (Xhevat Domi)

NDRECA Mikel (1926-2012). Gjuhëtar, leksikograf. Fushë kryesore e interesimit të tij është leksikografia shqipe. Ka hartuar disa fjalorë: Fjalor shqip-serbokroatisht (1976), Fjalor fjalësh e shprehjesh të huaja në gjuhën shqipe (1986), Fjalor shkollor serbokroatisht-shqip (1986) etj. Fjalori i fjalëve dhe i shprehjeve të huaja i Ndrecës ka për bazë lëndën leksikore të vjelë nga fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe (1954 e 1980), nga fjalorë dhe enciklopedi të ndryshme, nga veprat letrare e shkencore, nga tekstet shkollore, nga shtypi i përditshëm e periodik dhe nga mediumet e tjera të informimit publik. Ky fjalor përmban rreth 19,000 fjalë, shprehje e shkurtime, të cilat mund të klasifikohen: fjalë ndërkombëtare nga të gjitha sferat e veprimtarisë njerëzore dhe shoqërore, fjalë të vjetra (arkaizma e historizma) me burim të huaj, fjalë të reja me burim të huaj, dhe emra të përveçëm njerëzish me burim të huaj, që janë përdorur dhe përdoren ndër shqiptarë. (Mensur Vokri)

NEDELKOVIQ Bogolub (Bogoljub Nedeljковиć) (1920-1986). Politikan. Lindi në Gornje Selo të Prizrenit. Pas fillores dhe shkollës së mesme të kryera në Prizren, shkollën e Lartë Ekonomike e kreu në Zagreb. Ishte pjesëmarrës i Luftës Nacional Çlirimtarë dhe kreu funksione të ndryshme në Krahinën Socialiste Autonome (KSA) të Kosovës, në Serbi dhe në Jugosllavi. Ishte sekretar i Komitetit të PKJ-së të Qarkut, zëvendës drejtor i "Trepçës", drejtor i Xeherores "Ajvalia", sekretar i Komitetit Komunal të LK-së të Ferizajt dhe drejtor i Hekurudhave në Fushë-

Kosovë. Ishte anëtar i KQ të LKJ-së e anëtar dhe kryetar i kryesisë së Këshillit Republikan të Lidhjes Socialiste të Serbisë. Në periudhën 1974-1978 ishte kryetar i Këshillit Ekzekutiv të Kuvendit të KSA të Kosovës, pastaj kryetar i Lidhjes së Sindikatave të Jugosllavisë etj. (Ali Cenaj)

NEGOCIATAT E VJENËS KOSOVË-SERBI (2005-2007). Negociata të zhvilluara me ndërmjetësimin e përfaqësuesit të posaçëm të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së për sta-



NEGOCIATAT E VJENËS KOSOVË-SERBI (2005-2007)

tusin e ardhshëm të Kosovës, Marti Ahtisari, sipas kornizës së përgjithshme të zgjidhjes të përcaktuar në parimet e Grupit të Kontaktit. Delegacionet janë kryesuar nga presidenti e kryeministri i Serbisë, në njërën anë, dhe nga Ekipi i Unitetit të Kosovës, në anën tjetër. Procesi i negociatave është mbështetur në dy shtylla kryesore: takimet me palë të realizuara në Vjenë nën kryesimin e Ahtisarit dhe pyetësorëve tematikë të dërguara palëve për të nxitur prezentimin e propozimeve rreth zgjidhjeve të ardhshme kushtetuese. Takimi i fundit është mbajtur në mars të vitit 2007, duke u dhënë fund negociatave që zgjatën 14 muaj, pas të cilave kryesuesi konstatoi mungesën e vullnetit të palëve për të lëvizur nga qëndrimet e shprehura më parë. Në fund të punës së tij Ahtisari i vuri në dispozicion Sekretari të Përgjithshëm të OKB-së “Planin gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës”. Tentime shtesë për gjetje të një zgjidhjeje të pranueshme për të dy palët janë realizuar nga ekipi i treshes së përfaqësuesve të Bashkimit Europian, Federatës Ruse dhe SHBA-së (F. Uisner, W. Ishinger dhe A. Botsan-Harçenko). Në dhjetor 2007 treshja e informoi Sekretarin e Përgjithshëm për shter-

jen e të gjitha mundësive dhe për mungesën e marrëveshjes ndërmjet palëve, gjë që hapi rrugën për shpallje të pavarësisë së Kosovës. (Ilir Dugolli.)

NEKROPOLI I MATIÇANIT. Në vendin e quajtur “Bregu i Ajetit”, në fshatin Matiçan (në afërsi të Prishtinës), u zbuluan objekte me rëndësi të veçantë arkeologjike. Gjetjet e para



NEKROPOLI I MATIÇANIT

janë të rastësishme dhe datojnë nga viti 1964. Gërmimet sistematike në këtë lokalitet janë bërë brenda viteve 1969-1973, në organizim të Muzeut të Kosovës, në bashkëpunim me Fakultetin Filozofik të Universitetit të Beogradit. Materiali i zbuluar në Nekropolin e Matiçanit u publikua në vitin 1981 në një botim të veçantë në gjuhë frënge. U eksploran 112 varre mesjetare, si dhe mbetje të një vendbanimi neolitik, që mund të vihet në raport me grupin kulturor të Vinçës. Një pjesë e madhe e thesarit arkeologjik të këtij nekropoli daton nga shek. X-XI, por supozohet që ky thesar arkeologjik të jetë edhe më i hershëm, nga shek. VIII-IX. Thesari arkeologjik i zbuluar në Nekropolin e Matiçanit zë vend të veçantë te nekropolet mesjetare në Ballkan. Me gërmime arkeologjike është zbuluar material i luajtshëm arkeologjik në 43 varre. Aty janë zbuluar edhe vegla pune, nga të cilat një drapër dhe një thikë. Të gjitha objektet e tjera janë me karakter zbukurues dhe janë kryesisht nga varret e femrave, si unaza, bylyzykë, vathë, qafore dhe varëse të ndryshme. Janë zbuluar 43 ekzemplarë unazash të punuara nga bronzi, argjendi etj., të cilat e përfaqësojnë më së miri këtë zbulim dhe tregojnë një gamë të gjerë tipologjike. Po ashtu janë zbuluar edhe lloje të ndryshme të bylyzykëve, disa prej të cilëve janë me dekorime gjeometrike, në

formën e gjarprit etj. Vend të veçantë në këtë thesar arkeologjik zënë edhe qaforet, të cilat përbëhen nga perlat me qelq shumëngjyresh dhe varëse të rëndomta nga bronzi. Vlen të përmendet qaforja më e madhe që është gjetur në varrin, e cila përbëhet prej 1,494 perlave. Punimet në materiale të çmuara, pastaj edhe me gurë dekorativë të çmuar, si dhe me motive të llojllojshme duket se kanë qenë prodhime të një punëtorie vendore, e cila dëshmon aftësi artizanale dhe artistike të argjendarëve vendës, si dhe reflekton një status të lartë ekonomik e social të të ndërësve të varrosur aty.

Analizat antropologjike të 30 trupave skeletore ka treguar se këta persona i takonin tipit *dolihoqefal*, një tip mjaft i fuqishëm. Studimet antropologjike për popullsinë ilire kanë treguar se në pjesën më të madhe ilirët janë pikërisht të tipit *dolihoqefal*. Këto rezultate antropologjike, si dhe ngjashmëria e objekteve arkeologjike (figurat me motive gjeometrike, byzylykë në formë spirale, byzylykë në formë të gjarprit të stilizuar etj.) janë dëshmi se Nekropoli i Matiçanit i takon popullsisë vendëse të krishterë ilire-arbërore. (Kujtime Boshtrakaj)

NEKROPOLI I ROMAJËS. Vendvarrim tumular i epokës së hekurit. Gjetet te fshati Romajë i Hasit, në jugperëndim të Rrafshit të Dukagjinit. Tumat janë ngritur te vendi me mikrotoponimin “Sakra”, që shtrihet në bregun e djathtë të Drinit të Bardhë. Nekropoli përbëhet nga 16 tuma, në një zonë kishte 12, ndërsa në tjetrën 4 tuma. Gërmimet u zhvilluan nga Enti për Mbrojtjen e Monumenteve Kulturore dhe të Natyrës të Prizrenit (1970, 1972-1973). Tuma e dimensioneve të mëdha (40 x 5 m) u quajt “Tuma e luftëtarëve”, pasi në të u gjetën 38 varre me shumë armë, pos enëve dyvegjake dhe stolive prej qelibari. Riti i varrimit ishte me trupvënie dhe djegie, por kishte dhe varre kenotafe. Ndonëse kishte variante të ndërtimit të varrit, e përbashkëta ishte se janë ndërtuar me pllaka guri (40-60 x 5-10 cm). Pllakat janë renditur thjesht, pa material lidhës. Objekte të të njëjtës periudhë u gjetën dhe në tumat 2 dhe 3, të cilat si dhe të tjerat, kishin diametër rreth 25 metra dhe lartësi deri në 1 metër. “Tuma e luftëtarëve” përmbante varrin qendror të shek. VII p.e.r., varret e shek. VI-V p.e.r., por në tuma u gjetën dhe objekte të shek. III-II p.e.r. (Sedat Barajliu)

NEKROPOLI MESJETAR I BANJËS SË MALISHEVËS. Varre mesjetare të vendosura në tumën e shek. VIII-VII p.e.r. Gjetet te “Trojet e vjetra të telakëve të gurit” të Banjës së Malishevës. Varret mesjetare i takojnë shek. IX-XI të tipit me çati dyujëshë, të ndërtuara me rrasa të mëdha të gurit monolit, me orientim lindje-perëndim. Skeletet janë vënë mbi një shtrojë pllakash guri, me rit varrimi me trupvendosje në shpinë dhe duar të kryqëzuara mbi bark. Inventari përmban stoli bronzi tipike mesjetare. Gërmimet arkeologjike u zhvilluan në vitet 2005 e 2007. Varret i shtohen fondit të trashëgimisë kulturore të periudhës mesjetare të Kosovës, bashkë me varret mesjetare nga tumat e Përçevës, Llashticës, si dhe varret e Matiçanit, Gjonajt, Vërmicës e Grabocit të Ulët. (Luan Perzhita)

NEKROPOLI MESJETAR I BLLACËS. Varrezë mesjetare, që ndodhet në fshatin Bllacë të komunës së Suharekës, në anën e majtë të autostradës Prishtinë-Vërmicë. U zbulua gjatë ndërtimit të autostradës (2011). Në të u zbuluan mbi 40 varre të plota dhe disa të dëmtuara, të gjitha në formë katërkëndëshi. Varret janë ndërtuar kryesisht me rrasa guri dhe janë mbuluar po me rrasa, por të vendosura horizontalisht. Varret kishin drejtimin lindje-perëndim, me kokë të drejtuar nga perëndimi. Vetëm dy varre kishin inventar dhe është karakteristike se në një varr kishte dy të ndërës dhe njëri prej tyre kishte një amuletë në qafë. Për nga struktura arkitektonike, varret kanë ngjashmëri me varret e nekropolit mesjetar të Komanit. Mungesa e inventarit e bën të vështirë datimin më të saktë të nekropolit, pos faktit se nekropoli i takon periudhës mesjetare. (Shafi Gashi)

NEKROPOLI MESJETAR I BUDRIGËS. Vendvarrim mesjetar, i cili gjendet në fshatin Budrigë të Gjilanit. Ndonëse nuk është hulumtuar, shumë varre me kryqe të gurit dëshmojnë se ekziston një varrezë e mesjetës së vonë, me gjasë e shek. XIII-XIV. Në rrethinë ndodhen dhe disa lokalitete, si është ai neolitik i Budrigës së Ulët, rrënojat e kishës paleokristiane të shek. IV-VI dhe të kishës mesjetare. (Arben Arifi)

NEKROPOLI MESJETAR I GRABOCIT. Vendvarrim mesjetar, i cili gjendet buzë lumit Drenicë te Graboci i Ulët, rreth 10 km në perëndim të Fushë-Kosovës. Gjetet te

mikrotoponimi “Bahçe” në lagjen e Berishajve dhe në të janë gërmuar dhjetëra varre me inhumacion, fillimisht në vitin 2004 e më pas edhe në disa fushata gërmimi. Pjesa më e madhe kishte skelete në gjendje të mirë, me përjashtim të dy varreve që u mungonte kafka. Orientimi i varreve ishte perëndim-lindje dhe në to u gjetën armë, vegla pune, më rrallë enë qelqi dhe qeramike, përfshirë dhe atë të glazuar mesjetare. Veçohen stolitë, të cilat dominojnë me shumicë nga gjetjet e tjera: unaza, byzlykë e vathë bronzi, këto të fundit të granuluara. Inventari i varreve dhe trajtimi stilistik i stolive kanë analogji me gjetjet e varrezës së Matičanit të shek. IX-XI, që përkon dhe me kulturën arbërore të Komanit. Varreza ka shtrirje të madhe hapësinore dhe lidhet me qytezën antike dhe mesjetare të “Kërshat e Halitajve”, ku janë gjetur fragmente enësh qeramike, tulla, tjeçulla, imbrikse etj. (Arben Arifi)

NEKROPOLI MESJETAR I VËRMICËS. Lokalitet antik dhe mesjetar. Gjendet në bregun e djathtë të Drinit të Bardhë të fshatit Vërmicë, 15 km në perëndim të Prizrenit. Në të u konsta-



tua shtresa e hollë e periudhës latene, me fibulë të tipit kelt të shek. II-I p.e.r., pastaj bazilika e krishterimit të hershëm e shek. V-VI me kriptë në gjakonikon, si dhe 450 varre mesjetare të shek. IX-XI, të vendosura mbi bazilikën e rrënuar dhe në jugperëndim të saj. Varret me pozitë perëndim-lindje janë vendosur në taban dhe në disa raste janë kufizuar me gurë ose pllaka gurësh. Inventari jo aq i pasur përbëhet nga vathë, unaza, byzlykë me brumë qelqi dhe nga tel bronzi i përdredhur. Gërmimet u realizuan nga Enti për Mbrojtjen e Monumenteve Kulturore dhe të Natyrës në Prizren gjatë viteve 1974-1975, para akumulimit të ujërave të

pendës së Fierzës (Shqipëri) dhe pas gjetjes së rastësishme të unazës prej ari me brumë qelqi të periudhës romake me mbishkrim “Probila”. Materiali i lëvizshëm u konservua shumë shpejt dhe u vendos në Muzeun Arkeologjik të hapur ndërkohë në Prizren. Materiali osteologjik u analizua nga antropologu hungarez J. Nemeshkeri, i cili dërgoi raport preliminar se është fjala për popullatë joslave, por rezultatet përfundimtare nuk arritën, për shkak të rrethanave të krijuara dhe vdekjes së tij. Me gjithë këtë dhe hulumtimeve me nivel shkencor dhe vendosje të objekteve në vitrinat e muzeut në kohë rekorde, nga viti 1981 nekropoli i Vërmicës u shfrytëzua nga politika e Serbisë për t’i akuzuar shqiptarët si “shkatërrues të varreve mesjetare serbe”. Materiali osteologjik u vendos përkohësisht në Hamamin e Prizrenit dhe sot gjendet në godinën e bërë enkas për të në vitin 1999. (Edi Shukriu)

NEKROPOLI PARAHISTORIK I BËRNICËS. Vendvarrim i kapërcyellit të epokës së bronzit në të hekurit (shek. XIII-IX p.e.r.), që ndodhet në potezin “Shevarikë”, në anën djathtë të përroit të Bërnicës së Poshtme afër Prishtinës. U hulumtua në vitet 1957-1958 dhe 1980 dhe sipas këtij lokaliteti arkeologjik mori emrin Kultura e Bërnicës. Në sipërfaqen prej 600 x 100 m janë zbuluar katër grupe varresh, të cilat përbëhen nga 10-20 varre, të vendosura 30-50 m larg njëri-tjetrit. Veçanti e tyre është djegia e kufomave dhe vendosja e mbetjeve në urna të qeramikës. Përjashtim bën varri me trup të shtrirë në shpinë, me një shpatë bronzi pranë dorës së djathtë. Urnat janë mbyllur me enë apo rrasë guri, ndërsa grupet e varreve janë mbuluar me konstruksione të ulëta toloide, nga gurë lumi dhe rrasa shtufi. Karakteristikë e nekropolit janë urnat bikonike me qafë cilindrike, pa vegje apo me dy deri në katër vegje, pjatat e thella konike me dy vegje të ngritura lart mbi grykë dhe me maja të zbukuruar me sumbulla konike. Objektet e bronzit janë të rralla. Në afërsi janë gjetur fragmente të shumta të qeramikës nga epoka e eneolitit, deri në periudhën romake, gjë që dëshmon ekzistimin e një vendbanimi shumështrësor. (Haxhi Mehmetaj)

NEKROPOLI PARAHISTORIK I KARAGAÇIT. Nekropol parahistorik dardan, që gjendet afër Zveçanit. Në këtë nekropol janë zbuluar dy horizonte varresh: varre të kulturës së Bërnicës (XII-IX p.e.r.) dhe të kulturës dardane të

epokës së hekurit (shek. VI-V p.e.r.). Horizonti i parë përbëhet nga varre me djegie dhe vendosje në urna, ndërsa i dyti nga konstruksione të dyfishta në formë rruzullore e drejtkëndore, të krijuar nga gurë lumi dhe gurë të thyer. Në horizontin e dytë nuk janë zbuluar mbetje mortore, andaj janë konsideruar si kenotafe. Konstruksionet drejtkëndore kishin inventar të pasur: enë qeramike, stoli bronzi (fibula, pulla tëmthore, rruaza qelibari) dhe armë hekuri (thika, hanxharë). Janë zbuluar dhe disa varre me djegie nga periudha e hershme romake. U hulumtua në vitet 1960-1962 nga Muzeu i Kosovës (Haxhi Mehmetaj)

NEKROPOLI PARAHISTORIK I KEQEKOLLËS. Varrezë e tipit të sheshtë e kulturës dardane të kapërcyellit të epokës së bronzit në të hekurit. Është varreza më e pasur e kulturës së Bërnicsës, e cila gjendet në mikrotoponimin “Rrezja-Lugu i Stans” i Keqekollës, rreth 22 km në verilindje të Prishtinës. U hulumtua në vitet 2002-2003, me ç’rast u zbuluan 67 varre me djegie, pasi mbetjet nga zjarrishta janë vendosur në urna. Urnat janë mbyllur me enë dhe janë vendosur në gropa dheu. Varret janë shënuar me nga një rrasë guri ose janë rrethuar me disa rrasa gurësh të papërpunuar. Përjashtim bëjnë dy varre me rrasa të modeluara në formë gjysmëharku. Në një varr u gjetën fragmentet e enës dyshe, me zbukurime gjeometrike, e thyer për qëllime kulti, sipas traditave ilire të varrimit. U zbuluan dhe urna dykonike, pjata të thella konike, kupa, filxhanë, stoli bronzi dhe qelibari. (Haxhi Mehmetaj)

NESIMI Remzi (1933-2018). Gjuhëtar, profesor. Lindi në Odër të Tetovës. Shkollimin fillor dhe të mesëm i kreu në Tetovë, ndërsa në Universitetin e Beogradit studioi për albanologji. Atje i përfundoi studimet pas-universitare, ndërsa doktoratën e mbrojti në Universitetin e Prishtinës (1989). Punoi si lektor i gjuhës shqipe në katedrën albanologjike në Universitetin e Beogradit (1962-1964), më pas mësimdhënës i gjuhës shqipe në Akademinë Pedagogjike në Shkup (1964-1975) dhe profesor në katedrën e gjuhës dhe të letërsisë shqipe në Universitetin e



REMZI NESIMI

Shkupit (1975-1999). Veprimtaria e tij shkencore shtrihet në disa fusha: studimi i të folmeve shqipe në Maqedoni, çështje të normës dhe kulturës gjuhësore, ndikimet ndër-gjuhësore, hartim tekstesh shkollore, përkthime etj. Botoi monografinë “E folmja e Dervenit” (2008), përmbledhjen “Çështje gjuhësore” (1996), një varg artikujsh nga fusha e gramatikës, onomastikës, kulturës së gjuhës etj. Është bashkautor në tekste universitare për mësimin e gjuhës shqipe për maqedonasit dhe serbët dhe autor/ bashkautor i një vargu tekstesh shkollore për gjuhën shqipe në Maqedoni. Mori pjesë në Kongresin e Drejtshkrimin dhe ishte anëtar i Këshillit Ndërkademi për Gjuhën Shqipe nga themelimi deri më 2015. (Berton Sulejmani)

NEUTRALITETI I BE-SË NDAJ STATUSIT TË KOSOVËS (2008-2015). Është qëndrimi zyrtar i Bashkimit Europian (BE) ndaj Republikës së Kosovës, sipas të cilit BE-ja, si tërësi, nuk e njeh kolektivisht pavarësinë e Kosovës, por vetëm shtetet e saj anëtare, secila individualisht. Prandaj BE-ja mbajti qëndrim të rezervuar që nga viti 2008, apo siç thuhet qëndrim neutral statusor. Ky formulim neutral jepet si sqarim në formë fusnote sa herë që në dokumentet e BE-së përdoret emërtimi “Kosovo*”, me shpjegimin shtesë se kjo “nuk paragjykon statusin final të Kosovës”, meqë nga 28 shtetet anëtare të BE-së, 5 shtete nuk e kanë njohur Republikën e Kosovës, prandaj institucionet e BE-së vazhdojnë të mbajnë qëndrim neutral ndaj statusit të saj. Deri në fund të vitit 2015, pesë shtete anëtare të BE-së nuk e kanë njohur Republikën e Kosovës: Spanja, Qipro, Greqia, Rumania dhe Sllovakia. Meqë njohja e një shteti të ri nga ana e BE-së është kompetencë ekskluzive e Këshillit Europian (ku vendimet merren me konsensus), kjo njëzëshmëri e 28 shteteve anëtare për njohjen e Republikës së Kosovës nuk ishte arritur deri në fund të vitit 2015. Si rrjedhojë, BE-ja aplikoi ndaj Kosovës një qasje tjetër nga qasja që BE-ja zbaton ndaj shteteve të tjera të Ballkanit Perëndimor. Fillimisht, që nga 1999, në vend të procesit standard të stabilizim-asocimit, Kosova ishte trajtuar brenda të ashtuquajturit Mekanizëm Përcjellës për Stabilizim-Asocimin (STM). Më pas nuk përdorej emri kushtetues i Republikës së Kosovës, por emërtimi “Kosovo” me fusnotë. Pra, neutraliteti i BE-së ndaj statusit të Kosovës nuk i lejonte Kosovës të

hynte në marrëdhënie të plota kontraktuale me BE-në si shtetet e tjera të Ballkanit Perëndimor. Vetëm më 22 tetor 2015, Këshilli i Ministrave të BE-së lejoi nënshkrimin e MSA-së me Kosovën, kurse më 27 tetor 2015 kryeministri i Kosovës nënshkroi MSA-në me përfaqësuesit e Komisionit Europian. (Blerim Reka)

NEVZATI Orhan (1940-). Politikan, avokat. Lindi në Prizren, shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në Prizren, ndërsa diplomoi në Fakultetin Ekonomik-Juridik në Nish. Në vitin 1965 zgjidhet kryetar i Lidhjes së Rinisë së Kosovës. Pas Plenumit të Brionëve ishte konfrontuar me kuadrot e vjetra të Kosovës, por mbajti qëndrim të ashpër kundër demonstratave të vitit 1968 dhe kërkesave politike të asaj kohe. Po atë vit zgjidhet në udhëheqjen e ngushtë të Lidhjes Komuniste të Serbisë, në krahun liberal me Marko Nikeziqin dhe Latinka Peroviqin. Pas dorëheqjes së tyre në vitin 1974, O. Nevzati tërhiqet nga politika dhe punon si avokat, duke mbrojtur klientë të njohur në shumë procese politike në Sarajevë, Beograd e Prishtinë. Ka botuar romanin në gjuhën shqipe “Lagjja e Sozit; dromca nga jeta e një shkollari” dhe disa libra publicistikë. Jeton në Beograd. (Ali Cenaj)

NEZIRAJ Jeton (1977-). Dramaturg, skenarist, publicist. Lindi në Kaçanik, ku mbaroi shkollimin fillor dhe të mesëm. Kreu studimet për dramaturgjiri në Fakultetin e Arteve të Universitetit të



JETON NEZIRAJ

Prishtinës (2002). Është themelues dhe drejtor i Qendrës “Multimedia”. Në vitet 2008 - 2011 ishte drejtor artistik i Teatrit Kombëtar të Kosovës. Është autor i disa dramave, si: “Liza po fle”, “Udhëtimi në Unmikistan” (bashkautor), “Sytë e shkruar”, “Enea i plagosur”, “Mësimi i ndaluar” (bashkautor), “Ura”, “Yue Madeleine Yue”, “Lufta në kohën e dashurisë”, “Shembja e kullës së Ajfilit”, “Fluturimi mbi teatrin e Kosovës”, “Peer Gynti nga Kosova”, “Gamomali”, “Departamenti AP” etj. Dramat e tij janë përkthyer dhe botuar edhe në disa gjuhë të huaja dhe janë inskenuar në skena të teatrove në Gjermani, Zvicër, Francë, Angli, SHBA, Suedi, Turqi, Serbi, Maqedoni etj. Është skenarist i filmit të metrazhit të gjatë “Gomarët e kufirit” dhe i disa filmave të metrazhit të

shkurtër, si dhe i monografive ““Dodona”, 1992 – 2002” (bashkautor) dhe “Faruk Begolli” (2007) etj. (Bekim Lumi)

NEZIRI Bardha (1986-). Balerinë. Lindi në Prishtinë, ku kreu shkollimin fillor, ndërsa mësimet për balet i mori në Shkollën e mesme të muzikës “Prenkë Jakova” në Prishtinë. Studimet për dizajn grafik i mbaroi në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. Mori pjesë në shumë shfaqje, si: “Transicion II”, “S’po dëgjohet gongu”, “Kontrast”, “Performancë”, “Mbrëmje e baletit klasik”, “Bukuroshja e fjetur”, “Carmen”, në operën “Dasma arbëreshe” etj. Që nga viti 2001 është pjesë e trupës së Baletit të Kosovës, ku është njëherësh edhe dizajnere dhe fotografe e kësaj trupe. (Ragip Sylaj)

NEZIRI Petrit (1977-). Aktor. Lindi në Tetovë, ku kreu shkollën fillore dhe të mesme, ndërsa studimet për aktrim i mbaroi në Fakultetin e Artit Dramatik të Universitetit të Shkupit. Luajti disa role në film dhe teatër. Rolet më të rëndësishme teatrore i realizoi në shfaqjet: “Mblesëria” e A. Çehovit, “Tartufi” e Molierit, “Eshtra që vijnë vonë” e T. Dervishit, “Dervishi dhe vdekja” e M. Selimoviqit etj. Luajti në filmin “Prapa territ” të A. Thaçit dhe “Koha e kometës” të F. Koçit. Ka qenë pjesëmarrës në disa festivale ndërkombëtare të teatrit. Disa vjet ka punuar në Qendrën Teatrore për Fëmijë në Shkup. Është aktor i Teatrit të Tetovës. (Salajdin Salihu)

NEZIRI Tahir (1951-). Gazetar. Lindi në fshatin Nishec të Prishtinës. Shkollimin fillor e kreu në vendlindje, gjimnazin në Prishtinë dhe studioi në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës për gazetari dhe diplomaci. Me gazetari filloi të merret nga viti 1973. Ishte gazetar reporter nga terreni në gazetën “Rilindja”, ku ndoqi zhvillime në fusha të ndryshme të jetës shoqërore dhe politike. Pas mbylljes së “Rilindjes” nga Serbia, punoi në gazetën “Bujku” dhe pas luftës së rish në gazetën “Rilindja”, deri në mbylljen e saj më 2002. (Bajrush Morina)

NEZIRI Zeqirja (1952-). Studiues i letërsisë dhe i folklorit. Lindi në fshatin Lluçan të Bujanocit, ku kreu edhe shkollimin fillor, ndërsa shkollimin e mesëm e bëri në Prishtinë dhe në Preshevë. Studimet universitare i mbaroi në Shkup, ndërkaq ato pasuniversitare, si edhe studimet e doktoratës në Universitetin e

Zagrebit. Nga viti 1977 është në marrëdhënie pune si pedagog i letërsisë gojore shqiptare, i letërsisë shqiptare të pararilindjes dhe të romantizmit arbëresh në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Shkupit. Ka botuar studimet monografike “Poezia e Budit” (1995), “Meshari i Buzukut” (2006) dhe “Vjershërimi i Varibobës” (2008) dhe botimin e veçantë në kroatisht “Kroatët për shqiptarët (Nga Rilindja Kombëtare deri më 1912)” (Zagreb, 1993); pastaj librat mësimorë: “Letërsia gojore shqiptare” (1997), “Epika gojore shqiptare” (2010) etj. Me kumtesa dhe referate ka marrë pjesë në tribuna e konferenca shkencore të mbajtura në Maqedoni, Kosovë dhe Shqipëri, si dhe është autor i një varg punimesh studimore nga fusha e historisë së letërsisë dhe e letërsisë gojore shqiptare. (Arbnora Dushi)

NEZIRI Zymer Ujkan (1946-). Mbledhës dhe studiues i folklorit, mësimdhënës universitar. Lindi në Zahaq të Pejës, në një familje me prejardhje nga Rugova. Kreu studimet



ZYMER NEZIRI

për gjuhë dhe letërsi shqipe në Prizren dhe Prishtinë (1971), ku më pas mbaroi dhe studimet pasuniversitare dhe mbrojti disertacionin e doktoratës (1995). Më 1971 u pranua si asistent në Institutin Albanologjik, por më 1973 e larguan për shkaqe politike. Për shkaqe politike ishte i arrestuar (1967-1981) dhe pesë herë ishte i përjashtuar nga puna (1968-1990). Më 1992 u punësua sërish në Institutin Albanologjik të Prishtinës, ku ishte përgjegjës i degës së folklorit (1996-2003). Si vjelës i pasionuar i folklorit, mblodhi në Rugovë 15 vëllime të eposit të kreshnikëve (1979-1988). Publikoi një sërë studimesh për folklorin, etnologjinë, letërsinë, historinë etj. Është autor i disa veprave, vëllime me lëndë folklorike dhe monografi studimore: “Epika legjendare e Rugovës” (dy vëllime, 2009, 2011), “Poetika e krahasimit” (2004), “Këngë të kreshnikëve” (antologji, 2013), “Eposi i Kreshnikëve dhe epika historike” (2006), “Epika gojore dhe etnokultura” (2008) etj. Ka mbajtur ligjërata për folklorin në Tetovë, Prishtinë, Prizren, Shkup dhe si profesor i ftuar në Poloni, Itali, Francë, Austri, si dhe hulumtues në SHBA dhe Austri. Është anëtar i asociacioneve

të ndryshme ndërkombëtare nga fusha e folklorit, etnologjisë dhe studiuesve shkencorë të kësaj fushe. Kryeson Komisionin qeveritar për përgatitjen e dosjes së eposit të kreshnikëve për UNESCO. (Enver Mehmeti)

NËNË TEREZA (Gonxhe Bojaxhiu) (1910-1997) Motër nderi e Kishës Katolike, humaniste. Lindi në Shkup, në familjen Bojaxhiu me prejardhje nga Prizreni. U pagëzua në



NËNË TEREZA

Katedralen e Zembrës së Krishtit në Shkup. Vendimin për t'u bërë motër nderi e mori më 1928, në Letnicë të Vitisë, ku është Shenjtorja e Zojës, për të cilin Nënë Tereza ushqente një ndjenjë admirimi e përkushtimi të posaçëm. Hyri në Institutin e së Lumes Zojë, që njihej ndryshe me emrin “Motrat e Loretos”, në Irlandë. Atje mori emrin motër Mari Tereza, për nder të Shën Terezës së Krishtit Fëmijë. Në dhjetor të po atij viti u nis për në Indi, në Kalkutë. Në maj të vitit 1931 u dërgua në bashkësinë e Loretos, në Entali, ku dha mësim në shkollën për vajza, St. Mary. Për një kohë punoi si profesoreshë e historisë dhe e gjeografisë dhe më vonë si drejtore e shkollës për vajza, mirëpo gjatë gjithë kohës e tërhiqte puna me të varfër, me të sëmurët dhe me të braktisurit. Në vitin 1950, Vatikani miratoi bashkësinë rregulltare “Misionaret e dashurisë”, nëpërmjet së cilës Nënë Tereza do të realizojë punë të palodhshme bamirësie, humanizmi, paqeje e dashurie në Kalkutë dhe pastaj kudo tjetër në botë, duke përhapur frymën e humanizmit, të dashurisë dhe të përkujdesjes për të nëpërkëmburit e botës. Pas Kalkutës, u themeluan shtëpi të tjera në Romë e në Tanzani dhe, pak më vonë, në të gjitha kontinentet. Duke filluar nga viti 1980 deri më 1990, Nënë Tereza hapi shtëpi misioni pothuajse në të gjitha vendet komuniste, duke përfshirë ish-Bashkimin Sovjetik, Shqipërinë dhe Kubën.

Nënë Tereza mori Çmimin Nobel për Paqe më 1979 në Oslo. Kur mori çmimin, ajo tha: “Sa i përket gjakut dhe prejardhjes, unë jam shqiptare. Me shtetësi jam indiane. Sipas thirrjes jam rregulltare katolike dhe i përkas mbarë botës. Zemra ime i përket zemrës së Jezusit.” Më 1990 u shpall anëtare nderi e Akademisë

së Arteve dhe e Shkencave të Kosovës dhe përgjatë viteve 70-90, ajo pesë herë ka vizituar Kosovën, ndërsa në vitin 1993, bashkë me Papa Gjon Palin II, vizitoi Shqipërinë. Në vitin 1997 mori “Medaljen e Artë të Kongresit Amerikan” dhe u shpall qytetar nderi e Amerikës. U bë ikonë e shekullit, duke marrë epitetin “Nëna Shenjtëreshë”. Veprimtaria e saj u bë frymëzim për shumë misionarë anë e kënd botës. Misionaret e dashurisë kanë dhjetëra shtëpi dhe mijëra motra të nderit. Vdiq dhe u varros në Kalkutë të Indisë në moshën 87-vjeçare. Për shkak të përhapjes së famës së shenjtërisë, Papa Gjon Pali II lejoi menjherë të hapet çështja e kanonizimit. Në një ngjarje të jashtëzakonshme, më 19 tetor 2003, në Vatikan, para mijëra besimtarëve, Ati i Shenjtë Papa Gjon Pali II e shpalli të Lumnume Nënë Terezën, ndërsa më 4 shtator 2016, në ditën e 19-vjetorit të vdekjes, Ati i Shenjtë Papa Françesku e shpalli shenjtore Nënë Terezë. (Ndue Ukaj)

NIKAJ Dom Ndoc (1864-1951). Shkrimtar. Lindi në Shkodër në vitin 1864, ku kreu studimet teologjike në Seminarin Papnuer në vitin 1888. Ushtrroi një veprimtari të shumanshme si meshtar, shkrimtar, historian, publicist e si veprimtar politik. Në vitin 1892 bashkë me imzot Doçin, themeluan organizatën “Lidhja e Mshehtë”, e cila luajti një rol të madh në kryengritjen e Malsisë (1910-1912). Në vitin 1909 solli një shtypshkronjë në Shkodër ku filloi botimin e së përkohshmes “Koha” (1910) dhe të librave në shqip. Bashkëpunoi me “Albanian” e Konicës me pseudonimin Nakdomonici. Në vitin 1946, në moshën 82-vjeçare u arrestua nga regjimi komunist. Vdiq në burg në vitin 1951. Ndryshe prirjes mbizotëruese të letërsisë shqipe drejt poezisë, N. Nikaj si shkrimtar gjeti si formë të shprehjes letrare gjininë e romanit, kryesisht romanin historik, por edhe atë sentimental. Shkroi studime historike, tekste fetare dhe shkollore. Botoi shumë vepra ndër të cilat më të rëndësishmet janë: “Vakinat e scëites kisc (1888), “Marcja” (1899), “Historia E Shcypniis” (1902), “Historija e Turkiis” (përkthim, (1902), “Dashunia e msheftë” (1905), “Bleta nner lule t’Parrizit” (1907), “Shkodra e rrethueme” (1913), “Tivari i marrun” (1915), “Bukurusha” (1918), “Fejesa ndjep: A se Ulqini i mârrun” (1918), “Lulet në thes” (1918), “Burbuqja” (1920), “Lulja e

veshkun” (1920), “Motra për vllan” (1921). (Mark Marku)

NIKÇI Elez (1953-). Balerin. Lindi në Shtupeq të Madh të Rugovës. Shkollën fillore e kreu në Pejë, ndërsa Shkollën e Baletit në Shkup (1972). Pas përfundimit të shkollimit dhe deri



ELEZ NIKÇI

më 1991 punoi si balerin në Baletin e Kosovës, ku shpesh edhe si bartës i roleve kryesore luajti në shfaqjet: “Sokoli e Mirusha”, “Ritme të zgjuara”, “Kënga e Rexhës”, “Legjenda mbi ngadhënjimin”, “Paralojë dasme”, “Besa”, “Halili e Hajrija”, “Vallja pranverore”, “Romeo e Zhuljeta”, “Balloja e kadetëve”, “Piter Pan”, “Kopelia”, “Motive kosovare”, “Mbrëmje baleti”, “Carmen”, “Zef Lush Marku”, “Don Kishoti”, “E bukura More” etj. Gjatë viteve 1996-1999 ka qenë zëvendës-drejtor i Ansambllit të Këngëve dhe Valleve Popullore “Shota”. Punoi gjithashtu edhe si mësimdhënës i baletit në Shkollën e Mesme të Baletit në Prishtinë. Ishte i angazhuar edhe në protokollin e presidentit të Kosovës, Ibrahim Rugova. (Naime Beqiraj)

NIKEZIQI Bilal (1955-). Piktur. Lindi në Ulqin, ku kreu shkollën fillore dhe të mesme. Kreu Akademinë e Arteve në Prishtinë më 1978. Është anëtar i Shoqatës Mbarëshqiptare të Arti-



BILAL NIKEZIQI

stëve Figurativë me seli në Tiranë, pastaj anëtar i Shoqatës së Artistëve Figurativë të Malit të Zi. Në kuadër të aktivitetit të këtyre shoqatave mori pjesë në disa ekspozita kolektive në Mal të Zi, në Shqipëri, në Kosovë dhe në Gjermani. Hapi disa ekspozitat individuale, veçmas në Galerinë e Kullës së Balshajve në Ulqin (më 1988, 1990, 1993, 2001), pastaj në Galerinë “Buqa” në Tivar (Mal të Zi), në Galerinë Kombëtare të Arteve në Tiranë, në Galeritë “Art” dhe “Most” në Podgoricë, “Rada” në Prizren dhe në Galerinë “Schroder” në Augsburg të Gjermanisë. Është fitues i disa çmimeve: Diploma speciale në ekspozitën e tretë ndërkombëtare në Novi-Sad (1974), çmimin e parë për pikturë

në ekspozitën e studentëve të Akademisë së Arteve në Prishtinë më 1977. Është mësimdhënësi i artit figurativ në shkollën e mesme të Ulqinit. Në krijimtari kultivon frymën e re të realizmit magjik me shtrirje lirike. (Rexhep Ferri)

NIKIQ (Nikić) Milorad (1929-1987). Mjek, epidemiolog, ligjërues i lartë. Lindi në Pejë, shkollën fillore dhe të mesme i përfundoi në Pejë, Fakultetin e Mjekësisë në Universitetin e Beogradit (1963). Pas diplomimit u punësua në shërbimin higjienik-epidemiologjik të Qendrës Mjekësore në Mitrovicë. Përfundoi specializimin nga epidemiologjia në Beograd, më pas u kthye në Mitrovicë. Me hapjen e Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë u angazhua si asistent dhe pastaj ligjërues i lartë i lëndës së epidemiologjisë. Ishte kryeshef i Institutit të Epidemiologjisë, pastaj drejtor i Qendrës Shëndetësore Rajonale të Mitrovicës, zëvendës-drejtor i Entit Krahinor për Mbrojtje Shëndetësore të Kosovës, si dhe kreu një sërë funksionesh në asociacionet shëndetësore në nivel krahinor, republikan dhe federativ. Ishte anëtar i shumë këshillave dhe komisioneve, përfshirë edhe anëtar i komisionit për specializime në lëndët e mjekësisë preventive, duke udhëhequr me dhjetëra kandidatë në specializim. Publikoi një mori punimesh profesionale dhe shkencore në revista të ndryshme të ish-Jugosllavisë. Në diferencimet ideopolitike pas viteve '80 u kundërvu politikës antishqiptare. (Iilir Begolli)

NILAJ-META Haxhi (1912-1994). Lahutar, rapsod popullor. Lindi në katundin Shtupeq i Vogël të Rugovës. Kishte në repertor 29 këngë me mbi 10,000 vargje të eposit të kreshnikëve, që u incizuan më 1987 dhe u botuan më 1997 në Institutin Albanologjik të Prishtinës në "Epikën legjendare të Rugovës, këngë të kreshnikëve e balada" (vëllimi V). Shquhet për vazhdimësinë e traditës familjare të këndimit me lahutë për kreshnikët. Ishte i biri i lahutarit të shquar, Metë Rrustemi dhe nip i Rrustem Ademit, po ashtu lahutar i njohur. Lahutar ishte edhe i biri, Shaban Haxhia, e tash edhe nipi, Salih Shabani. Ka kënduar edhe balada dhe këngë epike historike. Kultivoi me sukses rrëfimin e gjatë epik, duke i ruajtur përbërësit kryesorë të këtij loji të këngëve. (Zymer U. Neziri)

NIMANI Alban (1977-). Dizajner. Lindi në Prishtinë. Kreu studimet për dizajn grafik në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës



ALBAN NIMANI

Ka marrë pjesë në rezidenca ndërkombëtare dhe ka realizuar vizita studimore në Turqi e SHBA. Merret dhe me muzikë: ka kompozuar për dokumentarë, ka realizuar disa videoklipe dhe ka publikuar albume muzikore. Ka hapur ekspozita personale në Kosovë, Shqipëri dhe SHBA dhe ka marrë pjesë në shumë ekspozita kolektive e festivale në vend dhe jashtë. Është pjesëmarrës në disa konferenca dhe prezantime publike në Prishtinë dhe gjetiu. Mori edhe disa çmime për dizajn, si pulla postare në Filatelinë e Kosovës (2007, 2008) dhe çmime në festivale muzikore (Shqipëri 2004, 2006, Slloveni 2007). (Zeni Balazhi)


NIMANI Aziz (1936-2005). Pikturor. Lindi në Pejë. Mbaroi shkollimin fillor dhe të mesëm në Pejë, ndërsa Shkollën e Lartë Pedagogjike, degën e artit figurativ, në Prishtinë. Kreu studimet në Akademinë e Arteve të Bukura në Lion të Francës. Një kohë jetoi e veprroi në Francë, duke kultivuar shprehjen impresioniste. Veprat e tij u vlerësuan nga publiku dhe nga kritika. Kështu, më 1976 në "Salon d'Hiver" në Lion mori çmimin e parë për pikturë. Pas kthimit në Kosovë, në kuadër të Shoqatës së Artistëve Figurativë të Kosovës mori pjesë në ekspozita kolektive brenda dhe jashtë vendit. Hapi disa ekspozita personale: në Lion, Francë (1974), Romenay, Francë (1979), Pleasantan, SHBA (1999) dhe në Prishtinë (2005). Arti i tij veçohet për nga fryma reale dhe impulsive, ku spikasin ngjyrat e ndritshme. (Rexhep Goçi)

NIMANI Elhami (1917-1998). Pjesëtar i LNÇ-së, funksionar i lartë i Partisë Komuniste Jugosllave (PKJ). Lindi në Gjakovë. Si i ri emigroi në Shqipëri, ku kreu Shkollën Normale në Elbasan. Më pas punoi si mësues në rrethin e Peshkopisë. Ishte pjesëmarrës në mbledhjen themeluese të Partisë Komuniste të Shqipërisë nga grupi i "Të rinjve" (1941). U rikthye në Kosovë (1941). Ishte veprimtar i Lëvizjes

Nacionalçlirimtare (LNÇ), anëtar i organizatës vendore të PKJ-së të Prizrenit, komisar politik i aradhes partizane “Zenel Hajdini”, komisar në Brigadën I Maqedono-Kosovare. Pas Luftës së Dytë Botërore pati funksione të rëndësishme në Federatën e Jugosllavisë. Ishte deputet republikan e federativ në disa mandate, ambasador i Jugosllavisë në vende të ndryshme dhe ndihmësekretar federativ i Punëve të Jashtme. Vdiq në Follorinë të Greqisë, ndërsa u varros në Beograd. (Skënder Lutfiu).

NIMANI Fadil (1967-2001). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), i Ushtrisë Çlirimtare për Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc (UÇPMB) dhe i Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare, dëshmor. Lindi në fshatin Gërgoc të komunës së Gjakovës. Ishte i njohur me emrin e luftës “Komandant Tigr”. Ishte komandant i vijës së frontit në Sukë të Cërmjanit, në të cilën u plagos më 20 prill 1998. Plagë të tjera mori edhe në luftimet e zhvilluara më 7 e 8 shtator 1998. Mori pjesë në luftimet e njëpasnjëshme të zhvilluara për një vit e gjysmë radhazi në vijat e para të frontit në Jabllanicë, Cërmjan, Gërgoc, Zhebel, Buçan, Llugaxhi, Kralan, Junik, Kpuz, Çeskovë, Dellovë, anekënd Dukagjinit. Në muajt maj-korrik 1998 ishte përgjegjës për vijën e furnizimit me armatim nga Shqipëria. Ai drejtoi njësitin “Tigrat” dhe më 16 korrik 1998 u emërua komandant i policisë ushtarake të Zonës Operative të Dukagjinit. Pas përfundimit të luftës u angazhua në Trupat Mbrojtëse të Kosovës. Më pas u përfshi në radhët e UÇPMB-së, ndërkaq në fillim të shkurtit të vitit 2001, pas shpërthimit të luftës në Maqedoni u inkuadrua në radhët e Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare, ku u emërua komandant i Brigadës 113 “Ismet Jashari-Kumanova”. Ra heroikisht në njërën ndër betejat më të rrepta të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare më 25 maj 2001 në Vaksincë të Kumanovës. (Fetnete Ramosaj)

NIMANI Lah (1939-2008). Trajner i boksit. Lindi në fshatin Kostërc të Skënderajt. Shkolën fillore e kreu në vendlindje, të mesmen në Prishtinë, studimet në Universitetin e Beogradit (Fakultetin e Edukatës Fizike). Një kohë punoi si arsimtar i edukatës fizike në Mitrovicë. Karrierën e trajnerit e filloi në KB “Akumulatori” po në Mitrovicë. Në sezonin 1973/74 kaloi në KB “Prishtina”, me të cilën arriti sukses në



LAH NIMANI

garat brenda dhe jashtë vendit. Me boksierët e Prishtinës, si: Nazif Gashi, Bajram Hashani, Mehmet Bogujevci, Xhevdet Peci, Aziz Salihu, Sami Buzolli, Nusret Rexhepi e të tjerë L. Nimani fitoi pesë herë titullin e kampionit të ish-Jugosllavisë, gjashtë herë ishte nënkampion dhe tri herë zuri vendin e tretë. Ai përgatiti boksierët e përfaqësueses së ish-Jugosllavisë për lojërat olimpike për katër edicione radhazi (1976, 1980, 1984, 1988). Në Lojrat Olimpikë në Moskë (1980) me boksierin serb Slobodan Kaçar fitoi medaljen e artë. Vdiq në Oklahoma të SHBA-së dhe u varros në Prishtinë. (Ejup Llumnica)

NIMANI Shyqri (1941-). Dizajner. Lindi në Shkodër. Kreu studimet në Akademinë e Arteve Aplikative në Beograd (1967), ku kreu dhe studimet pasuniversitare. Për shumë vjet ishte



SHYQRI NIMANI

mësimdhënës i dizajnit grafik në Akademinë e Arteve të Universitetit të Prishtinës, si dhe drejtor i Galerisë së Arteve të Kosovës. Krijimtaria e tij artistike përfshin pllakatin, ilustrimet, logot, përgatitjen grafike të librit si dhe të gjitha disiplinat e aplikueshme në grafikë. Në vitet 1976-1978 qëndroi për hulumtim artistik në Japoni dhe më pas bëri disa udhëtime studimore në Angli, Francë, Itali, Shqipëri, Rusi, Spanjë, Greqi, SHBA, Singapor etj. Realizoi disa ekspozita personale: Cavtat (1971), Tokio (1978), Beograd (1971, 1975) si dhe mori pjesë në shumë ekspozita kolektive në vend dhe jashtë, në vendet e rajonit dhe më gjerë. Është fitues i disa çmimeve: për logon e Galerisë së Arteve të Kosovës (1980), për logon e Universitetit të Prishtinës (1979), për logon Grand Hotel Prishtina (1976), për logon e Kompanisë së Sigurimeve “Kosova” (1975), pastaj i çmimit vjetor të Shoqatës së Artistëve Aplikativë të Kosovës (1974), i çmimit vjetor në Sallonin e Tetorit në Beograd (1970), për logon e RTV Prishtina (1970) etj. (Zeni Balazhi)

NIMANI Xhavit (1919-2000). Funkionar i lartë politik i Kosovë në periudhën e autonomisë. Lindi në Gjakovë. Emigroi në Shqipëri, ku kreu shkollën Normale në Elbasan. Gjatë



XHAVIT NIMANI


Luftës së Dytë Botërore u kthye në Kosovë, ku u angazhua në lëvizjen komuniste ilegale dhe në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare në Kosovë, duke kryer detyra të rëndësishme politike e ushtarake, që i caktonte Komiteti Krahinor i Partisë Komuniste të Jugosllavisë (PKJ) për Kosovën. Ishte anëtar i Shtabit Operativ të Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe të Rrafshit të Dukagjinit dhe anëtar i Këshillit Nacionalçlirimtar të Kosovës në Konferencën e Bujanit. Pas Luftës së Dytë Botërore kreu detyra dhe funksione të larta partiake dhe shtetërore në Kosovë, Serbi dhe në Jugosllavi. Ka qenë anëtar i Byrosë dhe i Sekretariatit të Komitetit të Qarkut të PKJ për Kosovën (mars 1945), anëtar i Komitetit Qendror (KQ) i Partisë Komuniste të Serbisë (maj 1945), anëtar i KQ të LKJ, deputet në Kuvendin Popullor Federativ, anëtar i Kryesisë së Kuvendit të Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë, deputet i Kuvendit Popullor të Serbisë, Kryetar i Kryesisë së Kosovës (maj 1974 - gusht 1981). Pas vitit 1981 u shkarkua nga gjitha funksionet. Vdiq në Prishtinë. (Skënder Lutfiu).

NINULLA. Këngë lirike e ritualit familjar, që i këndohet foshnjës në djep, kur vihet në gjumë. Rëndom e interpreton nëna, gjyshja ose motra e foshnjës, duke improvizuar aty për aty. Është lloji më optimist i poezisë popullore. Në to nëna shpreh ëndrrat dhe dëshirat më të mira për rritjen, rininë, martesën dhe moshën e pjekurisë për fëmijën e saj. I këndohet si djalit, ashtu edhe vajzës. Dallimet gjinore që përcaktojnë jetën e foshnjës janë të dukshme. Djali duhet të rritet dhe të bëhet i aftë për të punuar, të jetë i mençur, i dashur, trim, dhe t'u përngjajë të parëve të tij ose edhe heronjve. Ndërkaq, vajza duhet të jetë e bukur dhe me fat, të jetë e vyeshme e punëtore dhe të ketë sa më shumë vëllezër. Në ninullat e mëparshme kërkohej që djali të rritet e të bëhet "çoban me dhen apo me dhi", të shkojë ushtar, të martohet, ta gëzojë jetën si bujk e si pleqnar i

zoti, kurse në ninullat më të reja nëna kërkon që djali të bëhet mësues, profesor, doktor, inxhinier etj. Dëshira të ngjashme paraqiten edhe për vajzën, që duhet të shkollohet dhe të emancipohet. Ninullat fillojnë me shprehjen onomatopeike "nina-nina" ose "luli-luli", e të ngjashme. Ninullat kanë kryesisht strukturë strofike dyvargëshe dhe ritëm të lehtë, që përputhet me lëvizjet e djepit. Kanë karakter utilitar, sepse këndohen, me qëllim që të ftohet gjumi, i cili parafytyrohet si figurë magjike, që vjen dhe e merr foshnjën, që e rrit dhe ia ruan shëndetin. Ninullat janë botuar pothuajse në të gjitha vëllimet me këngë të riteve familjare. (Sadri Fetiu)

NISHEVCI Herolind (1992-). Karateist. Lindi në Prishtinë. Nisi të merret me sportin e karatesë që në moshën 3-vjeçë. Është anëtar i klubit të karatesë "Ippon" nga Prishtina. Ka fituar të gjithë titujt dhe shumë medalje në garat ndërkombëtare. Pas pranimit të karatesë me të drejta të plota dhe si sport olimpik, ia solli Kosovës medaljen e bronzit nga Kampionati Botëror që u mbajt në Linz të Austrisë (25-30 tetor 2016), në kategorinë deri në 84 kg. Gjatë periudhës kur Kosova nuk ka qenë e pranuar ndërkombëtarisht, ka bërë gara për kombëtaren e Shqipërisë (2009-2014). (Florim Maliqaj)

NISHLIU Rona (1986-). Këngëtare dhe autore e muzikës xhaz dhe e muzikës bashkëkohore shqipe. Lindi në Mitrovicë. Është e para këngëtare nga Kosova që ka arritur të fitojë "Festivalin



RONA NISHLIU

e Këngës në Radiotelevizionin Shqiptar", që ia hapi dyert e pjesëmarrjes në Festivalin "Eurovision 2012", me këngën "Suus", si përfaqësuese e Shqipërisë, e kthyer tashmë në një nga këngët historike të "Eurovisionit". Përmes stilit unik dhe angazhimit social ajo përdor skenën dhe këngën për të rrëfyer e folur mbi realitetin, përvojat e betejat e përditshme të jetës bashkëkohore. Është e para këngëtare shqiptare me koncert të plotë tematik mbi muzikën e kultivuar shqipe në skenën e Filarmonisë së Beogradit në vitin 2014. Punon në Radiotelevizionin e Kosovës. (Arnisa Rexhepi)

NITAJ Muharrem (1960-). Gazetar. Lindi në Drenoc të Deçanit. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, të mesmen në Deçan, ndërsa studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Universitetin e Prishtinës. Në vitin 1984 nis punën si gazetar në Radiotelevizionin e Prishtinës (RTP), më pas si redaktor dhe drejtues i “Programit të natës” në Radio Prishtinë deri në vitin 1990, kur u mbyll RTP-ja. Që nga viti 1993 ishte gazetar i seksionit shqip të Radios BBC, detyrë që e ka ushtruar deri në mbylljen e këtij seksioni, në vitin 2011. Gjatë viteve ’90 ishte kryetar i “Klubit të korrespondentëve të huaj” në Prishtinë. Në periudhën 2011-2013 punoi korrespondent nga Prishtina i fondacionit medial të Europës Juglindore “SE Times”. Një kohë ishte kolumnist i rregullt i gazetave të përditshme “Koha ditore” dhe “Zëri” dhe më pas opinionist në RTV-21 dhe në Televizionin “Klan Kosova”. (Rrahman Paçarizi)

NIXHA Lulzim (1950-). Inxhinier i arkitekturës, mësimdhënës universitar. Lindi në Prizren, ku mbaroi shkollimin fillor dhe të mesëm. Kreu studimet për arkitekturë në Universitetin e Sarajevës (1976). Punoi në Entin Urbanistik Komunal në Prishtinë (1978), në Bashkësinë Vetëqeverisëse të Interesit të Banesave dhe Lokaleve Afariste (1979), ndërsa në vitin 1984 u angazhua si asistent në katedrën e projekttimeve në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe të Arkitekturës të Universitetit të Prishtinës (UP). Më pas u zgjodh ligjërues për lëndën projektimi i objekteve shoqërore në katedrën e projekttimeve (1987) dhe gjithashtu merret aktivisht me praktikën profesionale në lëmin e arkitekturës dhe të urbanizmit. Nga viti 1975 projektonte aneksionin e Qendrës së Mesme të Shkollës Teknike në Prizren, shkollën e mesme në Komoran, objektet përcjellëse të xeherores Magure-Golesh, hallën sportive “25 Maji” në Prishtinë, një sërë objektivësh banesore dhe administrative në qytete të ndryshme të Kosovës etj. Kreu detyra me përgjegjësi në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe të Arkitekturës, ishte kryetar i Shoqatës së Arkitektëve të Kosovës dhe drejtor i urbanizmit në komunën e Prishtinës (2004-2008) etj. (Dervish Qerreti)

NIXHA Masar (1937-). Basketbollist, trajner, profesor universitar. Lindi në Gjakovë. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Prizren, ndërsa Shkollën e Mesme të Arteve në Pejë.



MASAR NIXHA

Kreu Fakultetin e Kulturës Fizike në Universitetin e Beogradit më 1965. Po në Beograd mbaron studimet pasuniversitare dhe mbron tezën e disertacionit të doktoratës (1986). Me basketboll nisi të merret që fëmijë, si anëtar i KB “Bashkimi” të Prizrenit, ndërsa veshi edhe fanellat e skuadrave “Buduqnosti” (Pejë) dhe “Studenti” (Beograd). Karrierën si trajner e filloi në KB “Bashkimi” në vitin 1962, të cilin e udhëhoqi deri në vitin 1986. Udhëhoqi edhe KB “Universiteti” (femrat) dhe ishte trajner i KB “Prishtina” (meshkujt). Një kohë ishte trajner i skuadrës “Shkëndija” nga Tetova, ndërsa më vonë edhe i skuadrës “Drita” të Gjilanit. Është autor dhe bashkautor i disa teksteve universitare. Në periudhën 1980-2004 ligjëroi lëndët e basketbollit dhe skijimit në Fakultetin e Kulturës Fizike të Universitetit të Prishtinës. (Bekim Aliu)

NIXHA Shqipe (1949-2015). Inxhinierë e arkitekturës, mësimdhënëse universitare. Lindi në Gjakovë, shkollimin fillor dhe të mesëm i kreu në vendlindje dhe në Prishtinë,



SHQIPE NIXHA

ndërsa studimet e larta për arkitekturë dhe urbanizëm në Universitetin e Sarajevës. Studimet pasuniversitare i kreu në Universitetin e Zagrebit. Në fillim punoi në byronë për projektim të kombinatit industrial “Ramiz Sadiku”, pastaj në Entin për Urbanizëm në Prishtinë. Në vitin 1980 u zgjodh asistente, më pas ligjëruese në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe të Arkitekturës të Universitetit të Prishtinës (1987). Që nga viti 1987 drejtoi katedrën e historisë së arkitekturës dhe mbajti lëndën historia e arkitekturës dhe e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore. Fushë kryesore e interesimit të saj shkencor ishte mbrojtja e trashëgimisë kulturore. Ishte autore e projektit të konservimit, restaurimit dhe rivitalizimit të kullës së Kukleciçit në Isniq, të strategjisë për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në projektin e planit të përgjithshëm të Prizrenit (2003-2013). Ishte anëtare e bordit

të ekspertëve për projektet e restaurimit dhe të rehabilitimit të monumenteve të trashëgimisë kulturore në Kosovë. Mori pjesë me kumtesa në konferenca shkencore dhe profesionale brenda dhe jashtë vendit. (Dervish Qerreti).

NIXHA-GRABOVCI Arbnesha (1969-). Aktore, pedagoge. Lindi në Pejë, ku kreu shkollimin fillor dhe të mesëm. U diplomua në degën e aktrimit në Fakultetin e Arteve të Uni-



ARBNESHA NIXHA-GRABOVCI

versitetit të Prishtinës (UP) në vitin 1994. Në vitet 1996/97 përfundoi specializimin për skenë dhe film në “College of Westminster” në Londër, kurse në vitet 1998/89 e vijoi punëtorinë në Teatrin Nacional të Londrës në klasën e

Helen Chedwick-ut. Është autore e një numri të realizimeve teatrore në skena të teatrove të Kosovës: “Dashnoret e Pikasos” (2012) në skenën e vogël të Teatrit Kombëtar të Kosovës (TKK), “Mblesëria, jubileu dhe ariu” (2013) në Teatrin “Dodona” në Prishtinë, “Miu” (2014) në Teatri “Istref Begolli” në Pejë, “Psikoza 46” (2015) sërisht në Teatrin “Dodona” etj. Ka luajtur edhe si aktore në teatër dhe në film, në shfaqjet “Hamleti” dhe “Duke pritur Godonë” në TKK, pastaj në projektet teatrore “Monologjet e vagjinës” (2012), “Çdo të hënë” në Teatrin “Oda” në Prishtinë, “Nora” (2012) sërisht në TKK etj. Në Fakultetin e Arteve të UP-së ligjëron lëndën e aktrimit. (Besim Rexhaj)

NOCIONE LETRARE. Janë shenjat e diskursit të kërkimit letrar dhe shenjat e para të identifikimit të natyrës së kërkimit. Nocionet kanë natyrë historiko-letrare dhe lidhen me epoka të caktuara, ndërsa nocionet teorike së pari lidhen me vepra konkrete, pastaj universalizohen dhe shenjojnë koncepte apo fenomene përtej një kohe e një vendi. Dijen letrare shqipe e shoqërojnë nocionet historiko-letrare, me origjinë dijet historike, sociale e ideologjike, si: periudhë, përmbajtje, materie, pasqyrim, porosi etj. Por kërkimet letrare moderne shqipe kanë farkuar nocione me bazë teoriko-letrare, të lidhura me natyrën e brendshme të letërsisë shqipe, me fuqi shumë më të madhe përgjithësuese. Në kërkimet historiko-letrare periudha është

nocioni që bën prerjet më të mëdha historike, të identifikueshme me periudhat e historisë sociale e nacionale. Përballë nocionit të periudhës, diskursi i dijes moderne vë qarkun letrar, ndërsa ky është shoqëruar nga nocioni i shkollës letrare, një herë si rrymë letrare e pastaj si praktikë e lidhur me një doktrinë apo me një korpus veprash, të cilat shfaqin ngjashmëri që përsëriten në shkallë konstantash. Nocionet e tipit: materie, pasqyrim dhe porosi janë të një natyre të fortë ideologjike e politike dhe, për shkak të pafuqisë për të shenjtur fenomene të brendshme letrare, janë eklipsuar ngadalë. Ndërsa nocionet me burim dijen letrare moderne kanë natyrë të fortë përgjithësuese dhe provohen në kërkimet e drejtpërdrejta letrare. Nocione letrare tipike për të shenjatur letërsinë e Kosovës janë: letërsia e Kosovës, e lidhur me vendin e me gjuhën e vendit; periudhat letrare, si shkallë të periodizimit letrar të letërsisë shqipe; formacion letrar, në kuptimin e praktikës letrare, të karakterizuar nga konstanta e shndërrime dhe të dëshmuar me vepra; qark letrar, si nocion që ka për bazë kontekstin kulturor e letrar të vendit dhe që tipologjinë letrare e kthen në kategori historiko-letrare; shkollë letrare, në kuptimin e një praktike letrare (tipologjike) të veçantë; autorë të Kosovës, të lidhur me vendin e me gjuhën shqipe si gjuhë të vendit. (Kujtim M. Shala)

NOJANI Fevzi (1924-2000). Ekonomist. Lindi në Prizren, diplomoi për ekonomi në Universitetin e Zagrebit (1950) si njëri ndër të parët shqiptarë të këtij profili në Kosovë. Pas përfundimit të studimeve punësohet në një institucion shtetëror për tregti të jashtme në Zagreb, më vonë kthehet në Kosovë dhe punon në Kombinatin “Trepça”. Më pas zë punë në Entin Statistikor të Kosovës dhe pas një kohe të shkurtër punësohet në Entin Krahinor të Planit të Kosovës. Pas ndryshimeve politike në Kosovë emërohet këshilltar i drejtorit të këtij institucioni. Gjatë tërë jetës ishte i angazhuar për avancimin e pozitës politike dhe ekonomike të Kosovës në ish-Jugosllavi. Preokupim i tij ishin çështjet strategjike, të cilat në qarqet profesionale i trajtonte me argumente, sidomos ato në fushën e problemeve zhvillimore të Kosovës. Dallohej për kompetencë të lartë profesionale. Ishte ideator i ndërtimit të rrugëve strategjike, me të cilat Kosova do të lidhej me

Shqipërinë, Pollogun dhe me korridoret e tjera ndërkombëtare, duke e shmangur izolimin e Kosovës nga aspekti i infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore. Ai mbeti ideatori më i përkushtuar i ndërtimit të autostradës në drejtim të Shqipërisë, me qëllim të avancimit të pozitës gjeostrategjike të Kosovës në rajon dhe më gjerë. (Halim Gjergjizi)


NOKSHIQI Agnesa (1975-). Koreografe, aktore, mësimdhënëse universitare. Lindi në Shkup, ku kreu shkollën fillore, ndërsa shkollën e mesme e kreu në Qendrën për edu-



AGNESA NOKSHIQI

kim muzikor dhe balet "Ilija Nikolovski-Luj" në Shkup. Më pas kreu Fakultetin e Arteve Dramatike në Shkup, degën e aktrimit (1998). Karrierën e saj si pedagoge e filloi si ligjëruese në Universitetin e Tetovës (1999) dhe më pas të Prishtinës, ku, në Fakultetin e Arteve, ligjëroi lëndët lojëra dhe lëvizje skenike. Si koreografe u shqua me shfaqjen "Muzeu" (2000) në Teatrin Shqiptar të Shkupit, ndërsa u paraqit edhe si autore, koreografe dhe regjisore e koreodramës eksperimentale "Kjo është normale" (2001) në Teatrin "Dodona" në Prishtinë. Është regjisore dhe koreografe e shfaqjes "Kanuni" (2005) të Teatrit "Oda" në Prishtinë, si dhe koreografe e një sërë performancash, si "Tregime nga Ballkani" (2008), "Lojëra të rrezikshme" (2008), "Përtej dhimbjes" (2009), "Vajza me diell në kokë" (2015) etj. Është gjithashtu koreografe e shfaqjeve "Trojanet" (2012), realizuar në Tetarin "Dodona" dhe "Jetë me qira" (2013) në Teatrin Shqiptar të Shkupit. Përveç si koreografe dhe regjisore, u angazhua si aktore në teatër dhe film. (Besim Rexhaj)

NOKSHIQI-ABI Abdurrahman (1941-2000). Balerin, koreograf, mësimdhënës universitar. Lindi në Pejë. Kreu Shkollën e Mesme të Balletit në Shkup. Për një kohë punoi si balerin dhe koreograf në Teatrin Maqedon në Shkup, e më vonë edhe në Teatrin Popullor në Zagreb. Kreu një kurs specializimi në Londër, ku mori leksione dhe përvojë nga pedagogë të njohur. Ishte njëri ndër balerinët dhe koreografët më të njohur në hapësirën shqiptare e më gjerë. U angazhua në shfaqje baleti në skenat e njohura, si:



ABDURRAHMAN NOKSHIQI-ABI

në Vjenë, Munih, Berlin, Bon etj., dhe si mysafir në shfaqje baleti në Tokio, në Amsterdam, Paris etj. Në Teatrin Popullor Krahinor (TPK) u angazhua si koreograf dhe ishte themelues dhe udhëheqës i trupës së baletit në këtë teatër. Interpretoi në shumicën e shfaqjeve të baletit në TPK gjatë viteve '70 dhe '80, si: "Halili e Hajria", "Bolero dhe Shtrausiana", "Legjenda mbi ngadhënjimin" etj., si dhe realizoi koreografinë e shfaqjeve: "Ritme të zgjuara", "Paralodje dasmë", "Motive kosovare", "Era dhe kolona", "E bukura more", "Loja e Sizifit" etj. Në vitin 1998, megjithë masat represive të regjimit të kohës, ai me sukses realizoi koreodramën "Odiseja shqiptare", përmes së cilës pasqyrore vuajtjet e shqiptarëve ndër vite. Tematika e kësaj koreodrame bëhet shkak për ndalim të reprizave të shfaqjes. Pavarësisht nga kjo janë gjendur mundësi dhe hapësira për dhënien e reprizave të kësaj koreodrame. Përveç këtyre koreografive ske-nike, A. Nokshiqi bëri koreografinë edhe të disa realizimeve televizive, të filmave si dhe të manifestimeve të shumta kulturore dhe artistike. Në periudhën 1989-2000 u angazhua si pedagog i lëndës lojëra dhe lëvizje skenike në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës dhe të Universitetit të Tetovës, në degën e artit dramatik. Gjatë periudhës së punës aktive si koreograf ishte anëtar i jurive prestigjioze në ish-Jugosllavi, siç ishte juria në garat e baletit jugosllav, ku ishte anëtar pesë vjet radhazi (1982-1986). Për kontributin në artin skenik në fushën e baletit dhe të koreografisë mori çmime dhe mirënjohje. (Besim Rexhaj)

NOLI Fan Stilian (1882-1965). Poet, klerik i lartë, burrë shteti, përkthyes, kritik, historian e muzikolog. Lindi në Qytezë (Ibrik-Tepe), vendbanim shqiptar në Edrene, në Turqinë Europiane. U shkollua në greqisht në vendlindje e më pas në gjimnazin e Adrianopojës dhe studioi për muzikë bizantine në katedralen ortodokse. Me dëshirën për të studiuar filozofi qëndroi në Athinë gjatë



FAN STILIAN NOLI

viteve 1901-1903, ku punoi dhe si sufler në një teatër ambulant. Botoi shkrime të vogla greqisht në gazetën “Numas” të Athinës. Më 1904, teksa punonte si mësues e psalt kishe në Egjipt, u njoh me Spiro Dinen dhe veprimtarë të tjerë të Lëvizjes Kombëtare. Nisi botimin e disa artikujve të “Drita” e Sofjes dhe përktheu greqisht “Shqipëria ç’ka qenë, çështje e çdo të bëhet” (1905). Më 1906 shkoi në SHBA, ku luajti rol vendimtar në organizimin e kolonive dhe punoi në gazetën “Kombi”. U dorëzua prift dhe më 22 mars 1908 mbajti për herë të parë liturgji në gjuhën shqipe, hapi i parë ky drejt organizimit dhe njohjes zyrtare të Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare. Më 1909 themeloi dhe botoi me F. Konicën gazetën “Dielli”. Nisi studimet për filozofi në Universitetin e Harvardit, ku u diplomua për arte më 1912. Këtë vit, me Konicën dhe të tjerë themeluan Federatën Panshqiptare të Amerikës “Vatra”, me gazetën “Dielli” si organ të saj dhe Nolin sekretar e më pas kryetar (1915). Kreu turneun e meshimit shqip në kolonitë shqiptare në Europë. Më 1913 vizitoi Shqipërinë, ndërmoi udhëtime diplomatike në Europën e Fuqive të Mëdha. I zgjedhur peshkop, shpall më 1918 autoqefale Kishën Shqiptare në SHBA. Po atë vit nisi botimin e revistës dygjuhëshe “The Adriatic review” (Revista Adriatike). Më 1921 kryesoi delegacionin shqiptar në Lidhjen e Kombeve, duke siguruar anëtarësimin e Shqipërisë. Pjesë aktive e jetës politike në vend, kryetar i Partisë Popullore më 1921, në parlamentin shqiptar dhe në shtyp ai kryesoi opozitën politike me prirje liberale demokratike deri në krizën e viti 1924. Në qershor të atij viti Noli provoi marrjen e pushtetit me dhunë përmes të ashtuquajturit Revolucion i Qershorit. Kryesoi qeverisjen e vendit 6 muaj. I mundur nga rikthimi i A. Zogut e nga dëshimi i reformave, mërgoi në Europë, ku vijoi luftën politike në krye të KONARE-së (1925), KÇN-së (1927), vit kur vizitoi Bashkimin Sovjetik, por edhe u dënua me vdekje në mungesë. Nisi botimin e gazetës “Republika” në Boston (1930), por në SHBA përfundimisht u kthye më 1932. Iu përkushtua krijimtarisë, përkthimit, studimeve dhe ortodoksisë shqiptare. Iu rikthye pasionit të muzikës dhe u diplomua në muzikologji (1938) me monografinë “Bethoveni dhe Revolucioni Francez”, botuar në Boston 1947. Mbas pushtimit fashist të Shqipërisë bashkëpunoi me Zogun I, Konicën e Çekrezin, për krijimin e “Bashkimit të Shenjtë”, mbështeti

idenë e krijimit të një qeverie mbretërore në mërgim, ndërsa mbas 1944 njohu qeverinë e Kongresit të Përmetit. Më 1945 mbrojti titullin “Doktor në filozofi” me disertacionin kushtuar Skënderbeut. U diplomua në Harvard edhe për gjuhët e vjetra hebraisht dhe aramaisht më 1963. Vdiq më 13 mars 1965 dhe prehet në varrezat e Forest Hills të Bostonit. Noli konsiderohet themelues i një shkolle të mirëfilltë përkthimi, bazuar mbi shqipërime brilante kryeveprash botërore. “Kthimi i Skënderbeut në Krujë” i Longfellout (1916), “Kasollja” e Ibanjezit (1921), tragjeditë shekspiriane “Otello” (1916), “Hamleti”, “Mak-beth”, “Jul Qesari”, dramat “Armiku i popullit” dhe “Zonja Ingra e Ostrotit” të Ibsenit, “Rubairat” e Khajamit (1926), “Don Kishoti” i Servantesit (1932) dhe poezia e Poes modeluan bibliotekën shqipe të letërsisë botërore. Shpesh botimin e tyre e shoqëroi me “Introdukta”, shkrime hyrëse, erudite, kritike e polemizuese, konceptuale, politike dhe imponuese, përmes të cilave themeloi tipin e kritikës letrare të angazhuar shqipe. Kontribut me vlerë sa letrare-gjuhësore, shpirtërore por dhe politike paraqesin përkthimet fetare e liturgjike. Në veprën studimore, Noli i rikthehet vazhdimisht figurës historike të Skënderbeut. Me tri botime të ripunuara (1921, 1947, 1950 dhe anglisht më 1949), “Historia e Skënderbeut (Gjergj Kastriotit), Mbretit të Shqipërisë, 1405-1468, prej peshkopit Theofan” synon çmimizimin e figurës historike dhe kontekstualizimin e tij. Sprovai herët shkrimin dramatik me dramën (e humbur) “Zgjimi”, shkruar dhe vënë në skenë greqisht në Athinë. Në shqip shkroi më 1902 po aty dramën me temë biblike “Israilitë dhe filistinë”. Si poet botoi vetëm përmbledhjen “Album” (Boston, 1948), me poezi të botuara kryesisht në shtyp. Me një kumbim të rrallë falë aliteracionit e lojës ritmike, poezia noliiane ka natyrë retorike, sundohet nga ideja e konceptualja, dialogu, tonaliteti marcial, tragjikja ose satira, qoftë në nivel autobiografik, qoftë në nivel të rrethanës së mprehtë politike. (Persida Asllani)

NOMIKËT. Shkrues ose noter publik, që, me kërkesë të palëve të interesuara, përpilonin dhe shkruanin akte private-juridike kundrejt kompensimit në para. Shkruesit publikë ishin të përhapur në tërë territorin e Perandorisë Bizantine, ndërsa në Konstandinopojë ata ishin të organizuar në esnafë të veçantë. Zakonisht ishin persona kishtarë. Aktet e nomikëve

shkruheshin sipas formularëve të caktuar dhe rregullonin marrëdhëniet privato-juridike, veçanërisht marrëveshjet shitblerëse. Sipas kodit të Justinianit I (529), neni 3, nomikët ngarkoheshin me pagesën e prikës nëse akti për të nuk tregojë i vërtetë. Institucioni i nomikut ishte i përhapur edhe në Durrës (1258). Kjo traditë u ruajt edhe gjatë sundimit rasian (serb), kur nomikët hasen në qendra të rëndësishme tregtare dhe xehetare, si në Shkup (1299-1300), në Prizren (1346-1366), në Trepçë dhe në Novobërdë (1410-1438). Meqë mungojnë burimet historike, nuk dihet me saktësi se si nomikët e këtyre qendrave i fitonin njohuritë, cilat ishin përgjegjësitë e tyre etj. Aktet e nomikëve ndonjëherë kishin edhe karakter publiko-juridik, siç ishte rasti i procesit gjyqësor midis Manastirit të Tetovës dhe njëfarë Progonit (para vitit 1346). (Qerim Dalipi)

NORÇA. Fshat i tipit të dendur, rreth 1.5 km në jug të Preshevës. Shtrihet në shpatet lindore të Karadakut, përgjatë rrugës rajonale Preshevë-Miratoc-Llojan-Vaksincë-Kumanovë, në lartësi mbidetare 510-630 m. Në periudhën 1948-2002 popullsia e Norçës është rritur nga 597 banorë, në 1,312 banorë. Sipërfaqja e komunës kadastrale është 701 ha. Zgjerimi territorial i fshatit dhe afërsia gjeografike me qytezën e Preshevës ka bërë që Norça në aspektin fizionomik të shkrihet në vazhdimsinë urbane-rurale, kurse migrimet ditore intensive në drejtim të qytetit kanë sjellë deri te transformimi diçka më i shprehur shoqëror dhe ekonomik. Kjo vërehet me angazhimin e një numri të caktuar të popullsisë në profesionet jobujqësore në qytetin e Preshevës. (Arsim Ejupi)

NORMALJA E ELBASANIT. Shkolla e parë e mesme, profesionale, pedagogjike shqipe në trevat shqiptare. Sipas vendimit të Kongresit të Elbasanit (2-9 shtator 1909), Normalja e Elbasanit u hap më 1 dhjetor 1909 për përgatitjen e mësuesve “për shkollat e para dhe të dyta.” Kishte gjashtë klasa: tri klasat e para përgatitore dhe tri klasa të tjera profesionale. Plani mësimor përmbante këto lëndë: gjuhë e letërsi shqipe, dituri mbi fenë (sipas përkatësisë fetare të nxënësve), matematikë, histori, shkenca të natyrës, gjeografi, logjikë, mësim gjanash, bukurshkrim, gjimnastikë, bazat e filozofisë me shkencat pedagogjike. Nga gjuhët



NXËNËS DHE MËSUES TË NORMALES SË ELBASANIT

e huaja, të obligueshme ishin: gjuha turke dhe gjuha frënge, ndërsa greqishtja dhe anglishtja sipas dëshirës. Mësimdhënësit e parë të saj ishin: Luigj Gurakuqi (drejtor), Akeksandër Xhuvani, Simon Shuteriqi, Peter Dodbiba, Hafiz Ibrahim Dalliu, Sotir Peci, Hasan Mezja dhe Dhimitër Papparisto. Drejtori shumëvjeçar i saj ishte Aleksandër Xhuvani. Në vitin e parë shkollor 1909/10 u regjistruan rreth 140 nxënës nga të gjitha trevat shqiptare, shumë prej të cilëve nga Kosova dhe Dibra. Për nisjen e fëmijëve për në Normalen e Elbasanit u mobilizuan klubet dhe shoqëritë patriotike shqiptare, komisionet e veçanta dhe atdhetarë të shquar nga të gjitha trevat shqiptare. Për shkuarjen e fëmijëve kosovarë në këtë shkollë punuan Nexhib Draga, Qazim Vuçitërna, Ilaz Vuçitërna dhe sidomos Hasan Prishtina. Normalen e hapi dhe e mbajti vetë populli shqiptar. Shkolla u vendos në një shtëpi private, ndërsa një shtëpi tjetër u shndërrua në konvikt për nxënësit që nuk ishin nga Elbasani. Historia e mëtejme e kësaj shkolle lidhet ngushtë me zhvillimet shoqërore-politike në Shqipëri. Ajo u mbyll dhe u hap disa herë deri në vitin 1922, kur filloi veprimtaria e pandërprerë e saj. Më 1923 në kuadër të saj hapet shkolla ushtrimore me drejtor Sulejman Harrin; më 1924 dalin maturantët e parë të diplomuar. Pas Luftës së Dytë Botërore, ajo u quajt Shkolla e mesme pedagogjike “Luigj Gurakuqi”, ndërsa më vonë u bë shkollë e mesme e përgjithshme. Gjatë punës së saj më se 100-vjeçare, Normalja e Elbasanit, përkatësisht Shkolla e mesme pedagogjike “Luigj Gurakuqi” u shndërrua në qendër kryesore të zhvillimit të mendimit dhe praktikës pedagogjike në Shqipëri. Nëpërmjet Normales së Elbasanit dhe ushtrimitores së

saj, Aleksandër Xhuvani, Sotir Paparisto etj., përhapën në Shqipëri përvojën shkollore austriake, gjermane, zvicerane etj. Normalja e Elbasanit kishte karakter mbarëkombëtar. Aty u arsimuan edhe nxënës nga Kosova, të cilët gjatë punës mësimore në Shqipëri dhe në Kosovë jetësuan në praktikë diturinë profesionale-shkencore të përfutur në këtë shkollë. Një numër i madh mësuesish nga Shqipëria, që punuan në shkollat e Kosovës dhe gjetiu, gjatë viteve 1941-1944 dhe më vonë, ishin ish-normalistë të Elbasanit. Disa prej tyre ishin edhe mësimdhënës në Normalen e Prishtinës, ku u përgatitën mësues për të gjitha trevat shqiptare jashtë Shqipërisë. Disa të tjerë u shquan si veprimtarë të arsimit në Kosovë. Ndikimi i Shkollës Normale të Elbasanit në Kosovë u shpreh edhe nëpërmjet teksteve shkollore, të hartuara në Kosovë, sipas modelit të teksteve mësimore të mësimdhënësve të Normales, sidomos të Aleksandër Xhuvanit. (Hajrullah Koliqi)

NORMALJA E PRISHTINËS. Normalja “Miladin Popoviq” në Prishtinë ishte shkollë e mesme profesionale për përgatitjen e mësuesve me mësim në gjuhën shqipe dhe në atë serbokroate. Filloi punën në vitin shkollor 1953/54 dhe veproi deri në vitin 1974, kur u shndërrua në akademi pedagogjike. Pararendëse e saj ishte Normalja e Gjakovës, e cila në vitin 1953 u transferua në Prishtinë. Fillimisht ishte shkollë katërvjeçare, ndërsa nga viti 1958 u shndërrua në shkollë me mësim pesëvjeçar. Përveç lëndëve të kulturës së përgjithshme nga shkencat natyrore e shoqërore, gjuhët dhe shkathësitë, plani dhe programi i kësaj shkolle përfshinte edhe shumë lëndë profesionale pedagogjike-psikologjike, si: pedagogji, psikologji, metodikë etj. Shkolla kishte edhe ushtrimoren e saj. Brezi i parë i nxënësve të kësaj shkolle diplomoi në vitin shkollor 1958/59. Përveç mësimit të rregullt, shkolla organizonte edhe forma të tjera arsimore për kualifikimin e mësuesve. Në këtë shkollë u arsimuan nxënës nga të gjitha trevat shqiptare në ish-Jugosllavi. U përgatitën mësues për shkolla shqipe jo vetëm në Kosovë, por edhe në Maqedoni, Mal të Zi, në Preshevë etj. Shkolla kishte edhe konviktin e saj për strehimin e nxënësve nga trevat jashtë Prishtinës. Ishte një qendër e rëndësishme arsimore dhe kulturore, ku punuan profesorë e mësimdhënës të shquar. Gjatë

punës së saj 25-vjeçare, në këtë shkollë diplomuan me mijëra mësues. Midis tyre u shquan shumë intelektualë, shkrimtarë dhe veprimtarë të fushave të ndryshme. (Dali Emrullahu)

NORMALJA E SHKUPIT. Shkolla normale “Zef Lush Marku” në Shkup u themelua më 1952. Pararendëse e saj ishte Shkolla Normale në Tetovë, e themeluar dy vjet më parë. Ishte shkollë e mesme profesionale për arsimimin e mësuesve. Në vitin shkollor 1966/67 në kuadër të saj u hapën edhe paralelet e para të gjimnazit. Në këtë shkollë u përgatitën mësues për shkollat shqipe në Maqedoni, Luginën e Preshevës, Malit të Zi dhe të Kosovës. Normalja e Shkupit fillimisht ishte trevjeçare, pastaj katër dhe pesëvjeçare. Shumica e nxënësve ishin të rregullt, por ajo organizoi edhe kurse pedagogjike për kualifikimin e mësuesve pa shkëputje nga puna. Gjatë punës së saj njëzetvjeçare (1952-1972), në Normalen e Shkupit u diplomuan për mësues 1,770 nxënës të rregullt dhe mbi 520 kandidatë të tjerë pa shkëputje nga puna. Normalja e Shkupi e vazhdoi punën deri në vitin shkollor 1971/72, kur diplomoi gjenerata e fundit e normalistëve dhe shkolla normale u shndërrua në gjimnaz. (Xheladin Murati)

NOTERIA E KOSOVËS. Veprimtari publike e lidhur me gjyqësinë, e cila nuk ka ekzistuar në sistemin e mëparshëm juridik të Kosovës. Me ligjin nr. 03/L-010 të Republikës së Kosovës rregullohet organizimi dhe funksionimi i noterisë si veprimtari publike në Kosovë. Noteria është organ që ka autorizime të pushtetit shtetëror, që të përpilojë shkresa publike për veprimet juridike, të legalizojë nënshkrime, kopjime, përkthime e të ngjashme; të pranojë para të gatshme, gjëra dhe letra me vlerë për t’ua dorëzuar personave të tjerë. Shtrirjen territoriale e bën Ministria e Drejtësisë, sipas parimit që në çdo komunë të ketë së paku një zyrë noteriale, ndërsa në komunat që kanë më tepër se 20,000 banorë numri i tyre mund të rritet. Noteri duhet të jetë i diplomuar në drejtësi dhe ta ketë dhënë provimin përkatës për noter. Ai është zyrtar publik, i cili në kushte të caktuara me ligj dhe pas konsultimit me Odën e Noterëve, përzgjidhet nga ana e komisionit përkatës të Ministrisë së Drejtësisë. Noteri duhet të jetë i regjistruar në Odën e Noterëve. Aktivitetet noteriale mbikëqyren periodikisht

dhe sipas rastit. Për punë të kundërligjshme noteri përgjigjet materialisht, penalisht dhe në procedurë disiplinore. Noterët mund të përfaqësojnë palët para organeve gjyqësore e administrative. (Ejup Sahiti)

NOVIK Aleksandër (Aleksandar Aleksandoviç) (1967-). Albanolog rus, etnolog. Shkollimin e kreu në Bobrujsk (Bjellorusi), studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Shën Peterburg. Studimet pasuniversitare i vijoi në Muzeun e Antropologjisë dhe të Etnografisë të Akademisë së Shkencave. Mbrojti tezën për kandidat të shkencave historike për prodhimin e veshjeve tradicionale shqiptare në fillim të shek. XX. Punon në departamentin e studimeve europiane të Muzeut. Nga 2004 është në krye të departamentit. Jep mësim për shqipen, etnografinë dhe historinë e popujve të Ballkanit në Universitetin e St. Peterburgut. Merr pjesë vazhdimisht në Seminarin për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare në Prishtinë (1990-2015) dhe kreu studime të shumta në terren në Shqipëri (Dukagjini, Golloborda, Gora, Himara, Devolli, zonat e Korçës dhe të Kolonjës), Kosovë, Itali, Bullgari (fshati i Mandricës), Mal të Zi, Ukrainë dhe vende të tjera. Botoi artikuj për veshjet popullore shqiptare, doket dhe traditat e shqiptarëve dhe të popujve të tjerë të Ballkanit. Për kontributin e tij në studimet albanologjike dhe për marrëdhëniet shqiptaro-ruse më 2012 u emërua Konsull i Nderit i Republikës së Shqipërisë në St. Peterburg. (Marija Morozova)

NOVIQ Millutin (Milutin Nović) (1914-). Aktor. Ishte anëtar i trupës së aktorëve të Dramës Serbe në kuadër të Teatrit Popullor Krahinor (TPK). Lindi në Gospodnjicima (Serbi, Vojvodinë). Në TPK erdhi në vitin 1952 dhe aty veprroi gati dhjetë vjet (1961), ku interpretoi role të ndryshme në shfaqjet: “Të gjithë bijtë e mi”, “Ruj Blaz”, “Tartufi”, “Rinia para gjyqit”, “Fëmija i komunës” etj. (Besim Rexhaj)

NOVOBËRDA (ARTANA). Vendbanim në pjesën qendrore të krahinës së Gollakut, ndërmjet Prishtinës dhe Gjilanit. Është e ndarë në tri lagje: Kalaja, Kolonia e Vjetër dhe Kolonia e Re. Në lokacionin e quajtur Kalaja jetojnë anëtarët e katër familjeve të Novobërdalive, ndërsa në Koloninë e Vjetër dhe të Re janë vendosur disa



NOVOBËRDA

familje shqiptare dhe serbe, të ardhur si punëtorë në miniera, kryesisht nga fshatrat: Marec, Vllasali, Bunjak, Tullar etj. Në dokumentet e periudhës romake Novobërda njihet si “Novus Mons”, sasët e quanin Nyeubergha, ndërsa në dokumentet sllave përmendet me emrin Novo Brdo, tek osmanët Novo Yerde. Në periudhën 1379-1450 në Novobërdë gjendej kolonia kryesore e raguzanëve. Që nga viti 1349 në Novobërdë punonte farkëtaria për prerjen e monedhave “Grossi di Nouaberda”. Nga viti 1444 Novobërda administrohet nga pushtuesit osmanë. Novobërda në kohën e mesjetës ishte ndër qytetet e zhvilluara dhe qendrat e mëdha të Gadishullit Ballkanik. Me pasuritë nëntokësore dhe shfrytëzimin e tyre njihet që nga periudha antike. Sot është një prej qendrave më të njohura xehetare të Kosovës. Në kompleksin e këtij vendbanimi gjenden edhe disa objekte të ruajtura të arkitekturës islame, ku më e rëndësishmja është xhamia, pastaj tyrbeja dhe dëshmitë e varrezave të vjetra në arealin e kompleksit. Në kompleksin e kalasë gjenden themelet e një kishe katolike. Në vitin 1913 Novobërda kishte 176 banorë, në vitin 1948 kishte 31 shtëpi me 232 banorë, në vitin 1981 kishte 38 shtëpi me 292 banorë. Deri në vitin 1965 ishte qendër komunale. Në vitin 1987 përsëri e fitoi statusin e qendrës administrative komunale. Në vitin 1949 filloi ndërtimi i kolonisë xehetare, ku vendosen kryesisht punëtorët e minierës nga vendbanimet e afërta, ndërsa në vitin 1967 filloi ndërtimi i kolonisë së re. Përveç ndërtesave të banimit, u ndërtua edhe hoteli, stacioni i policisë dhe ndërtesa e komunës. Kështjella e Novobërdës, xhamia dhe teqeja, peizazhet piktoreske të ruajtura nga ndërhyrja e njeriut ofrojnë mundësi për zhvillimin e turizmit. Në këtë vendbanim punon edhe zyra e turizmit rural. (Nazif Gashi)

NOVOBËRDA (ARTANA) (komuna). Komunë në lindje të Kosovës, me sipërfaqe prej 8,133 ha. Në veri kufizohet me komunën e Prishtinës, në jug me Gjilanin, në perëndim me Lipjanin dhe në lindje me Kamenicën. Territorin e komunës e përshkon rruga magjistrale Prishtinë-Gjilan. Relievi është kodrinor-malor, me ndërtim të llojllojshëm litologjik. Në forma të zonave të ngushta të shtrirjes ndërrohen formacionet e paleozoikut, mesozoikut dhe kenozoikut. Klima është kontinentale. Në territorin e komunës së Novobërdës pyjet dhe kullotat përbëjnë elementin kryesor të fizionomisë së peizazhit. Kushtet e mira natyrore dhe pasuritë nëntokësore mundësojnë popullimin e hershëm të territorit të komunës. Dëshmi për këtë janë gjetjet e shumta arkeologjike në lokalitetin afër Novobërdës, veçmas në kalanë e vjetër dhe në vendbanimet përreth saj. Në shekullin XV në Novobërdë jetonte tregtari Mikel Llukari, i cili në librin e tij kishte shënuar shumë emra njerëzish nga fshatrat e komunës së sotme të Novobërdës, të Kamenicës e më gjerë. Pas rënies së Perandorisë Osmane më 1912 dhe pushtimit serb të Kosovës fillon spastrimi etnik i këtyre vendbanimeve dhe popullimi me kolonë serbë e malazezë.

Vepriktaria kryesore e ekonomisë e kësaj komune një kohë të gjatë ishte xehetaria. Një numër i madh i banorëve ishte i punësuar në xeheroren afër qendrës komunale, ndërsa pjesa tjetër merrej me bujqësi, blegtori dhe aktivitete të tjera. Komuna e Novobërdës ka strukturë të përzier etnike. Jetojnë shqiptarë dhe serbë. Qyteti i Novobërdës me rrethinë gjatë mesjetës kishte më tepër se 40,000 banorë. Në vitin 1913 kishte 10 vendbanime me gjithsej 2,716 banorë. Në vitin 1948 kishte po 10 vendbanime me 550 familje dhe 3,044 banorë. Sipas regjistrimit të vitit 1991 (vlerësim) kjo komunë kishte 8,553 banorë. (Nazif Gashi)

NOVOBËRDA MESJETARE. Kështjellë në rrënoja në pjesën lindore të Kosovës, 39 km në juglindje të Prishtinës, e ngritur mbi malin në lartësi mbidetare prej 1,100 m, në brendësinë e të cilit fle një vullkan i shuar. Në studime historiografike dhe shkrime të ndryshme për lashtësinë e kështjellës së Novobërdës vetëm shkarazi është marrë parasysh njoftimi i Strabonit (63 p.e.s.-20 i e.s.), që thotë se fisi i galabrëve, që e banonte hapësirën e krahinës së sotme të Gollakut dhe më vonë u shpërngul në

Kalabrinë e Italisë së sotme, e kishte një qytet i cilësuar edhe si “Nëna e qyteteve” që quhej Damastion. Këtë qytet disa e mbajnë edhe për kryeqytet të Dardanisë, në hapësirën e së cilës janë gjetur rreth 40 monedha argjendi të prera aty qysh në shek. IV-III p.e.s, që e mbajnë emrin e tij. Ndoshta Damastioni i lashtë, apo një kështjellë bizantine e paemër, u dëshmua gjatë shek. XIII-XV me emrat: *Monte Novo, Novabarda, Nouaberda, Novus Mons, Novomonte, Novo Brdo e Novo Berda*; gjermanisht: *Neyberghe, Nyeu-berghe*, disa e quanin edhe “Qyteti i sasëve” ose “Qyteti i argjendit” (*Montana dell’ argento*). Ndërkaq, për Novobërdën flitet vetëm në kohën pas ardhjes së serbëve dhe pushtimit të këtij në shek. XIII, por jo edhe për historinë e tij më të lashtë. Por ruhen edhe njoftime, sipas të cilave mësohet se këtë qytet-kështjellë nuk e ngritën serbët dhe se më parë aty ishte një kështjellë bizantine, të cilën e rindërtoi mbreti serb Stefan Urosh II Milutini në vitin 1285. Se këtë qytet nuk e ngritën bizantinët dhe serbët flet rrethana që në një mur ballor të kështjellës me gurë ngjyrë kafeje është një mozaik që paraqet spirancën si simbol të marinës, ndërkohë që vetëm shqiptarët e rrethinave të Novobërdës e kremtojnë ditën e Shmarkut, që është padron i qytetit të Venedikut, i quajtur ndryshe edhe Republika e Shën Markut. Megjithatë, përmendjen më të moçme të këtij vendbanimi e përmban një shkresë raguzane e vitit 1319. Pikërisht mbi bazën e kësaj tradite, qytetit të Novobërdës ia njohën statusin special edhe pushtuesit serbë. Sado që qytetin e qeverisnin vojvoda (lat. *comes*), si kryekomandant i mbrojtjes, knezi si administrator dhe qefalium, jeta zhvillohej këtu sipas “Ligjit të Qytetit”, përkatësisht sipas rregullave të përcaktuara nga sasët e raguzanët sidomos në fushën e ekonomisë dhe të jetës shpirtërore, sepse mbledhësit e doganave, prerësit e monedhave dhe gjyqtarët në qytetin-minierë ishin rëndom sasë e raguzanë. Banorë të kështjellës ishin familje patricësh e tregtarësh raguzanë, kotorras dhe të ardhur nga qytete të jugut të Adriatikut, përkatësisht Kotorri, Tivari, Korçula, Spliti, Ulqini, Zara, apo edhe nga veriu i Arbërisë, si dhe zejtarë gjermanë, përkatësisht sasë. Midis banorëve të këtij qyteti kishte edhe tregtarë të ardhur aty nga Italia. Vojvoda i fundit i Novobërdës deri me pushtimin e saj nga osmanët në qershor të vitit 1455 ishte arbërori Lesh Spani nga qyteti i Drishtit.

Xehja e gllamës (argjend me 33% ar) nga miniera kryesore e Novobërdës dhe nga shumë puse në rrethinë të saj nxirrej dhe përpunohej nga minatorë sasë, të cilët kishin këtu (si edhe raguzanët) lagje më vete, me kisha të tyre dhe që kontestet më të mëdha juridike i zgjidhnin sipas të drejtës raguzane (*consules et iudices*) dhe gjermane (*curia Teotonicorum*). Mënyrën sase të administrimit të qyteteve, përkatësisht institucionin e këshillit të qytetit në gjithë Ballkanin e gëzonin vetëm kolonitë sase të Srebrenicës e të Novobërdës. Këtë status e ruajtën edhe një kohë pas pushtimit osman. (Skënder Gashi)

NOVOBËRDASI Valerian (Valerius Novomontanian) (1474-1493). Profesor i teologjisë, konventual në Raguzë e Lezhë dhe vikar gjeneral për Kosovë. Njoftime burimore për Valerin deri tash janë zbuluar në Arkivin e Dubrovnikut, regesta e korrespondenca të gjeneralëve (*magister generalis Ordinis*) të urdhrimit dominikan të Romës për Provincën e Dalmacisë (ku është përfshirë edhe territori i sotëm i Kosovës), si dhe në dorëshkrime të biografit e historianit raguzan, Serafin Maria Çerva (Seraphinus Maria Cerva, 1686-1759). Këto burime dëshmojnë për origjinën e Valerit nga Novobërda: “Qyteti është në Mezinë e Epërme i mbiquajtur nga banorët latinë Novus-Mons, por nga banorët e popullit ilir Novobërda. Është i vendosur mes qytetit të Drishtit në Dalmaci, Novi-Pazarit dhe Cecelisë (fshat afër Vushtrrisë) në largësinë 45-50,000 këmbë”. Njoftimet bëjnë të ditur se V. Novobërdasi kishte studiuar për filozofi dhe teologji dhe ishte shpallur profesor në disipinatat teologjike. Pjesën më të madhe të jetës e kaloi në shërbim të papatit. Nga këto lidhje është ruajtur një korrespondencë e tij me papën Inoçenti VIII (28 janar 1487), e cila ruan edhe vulën papnore. Në Raguzë ishin shpërngulur pindërit e V. Novobërdasit, pasi Novobërda ishte pushtuar nga Mehmeti II (1455). (Jahja Drançolli)

NOVOSELLA Selatin (1945-) Veprimtar i lëvizjes ilegale, ish-i burgosur politik. Lindi në Prishtinë. Që në moshën 18-vjeçare u angazhua në organizatën atdhetare Lëvizja Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve (LRBSH). Ishte njëri ndër organizatorët e demonstratave të vitit 1968. Për shkak të angazhimeve politike

dhe kombëtare, u arrestua dhe u dënua. Në fillim të viteve '90 u angazhua sërish në politikë, kësaj radhe në kuadër të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK). Ishte anëtar i Këshillit të Përgjithshëm të LDK-së, deputet i parlamentit të Republikës së Kosovës në zgjedhjet e organizuara nga LDK-ja në vitin 1992, pastaj kryetar i Këshillit Koordinues të degëve të partive politike në Prishtinë, kryetar i Këshillit për Ndhimja Emergjente. Në vitin 1999 u zgjodh nënkryetar i komunës së Prishtinës, kurse në vitin 2004 kryetar i Shoqatës së të Burgosurve Politikë të Kosovës. Në vitin 2005 u zgjodh anëtar i Këshillit Drejtues të Prishtinës të Partisë Demokratike të Kosovës. Ka botuar një sërë librash publicistikë për lëvizjen ilegale dhe për personalitetet të shquara të kësaj lëvizjeje (Izber Hoti)

NOVOSELLA. Fshat në komunën e Pejës, 8 km në verilindje të saj, shtrihet në rrjedhën e epërme të Drinit të Bardhë në lartësi mbidetare 510 m. Në aspektin morfologjik i takon tipit të shpërndarë, me sipërfaqe 2,393 ha, kryesisht pyje dhe livadhe, më pak ara. Popullsia merret kryesisht me blegtori dhe bujqësi ekstensive. Si vendbanim me 30 shtëpi përmendet në regjistrin kadastral osman të Sanxhakut të vitit 1485. Në sallnamet e vilajetit të Kosovës të vitit 1893, 1896 dhe 1900 figuron me emërtimin Jeni Koj. Pas vitit 1945 një numër i konsiderueshëm i banorëve të fshatit emigroi brenda dhe jashtë Kosovës. Ndonëse emigrimi mori përmasa, numri i popullsisë së fshatit vazhdoi të rritet. Derisa në vitin 1921 kishte 442 banorë, në vitin 2011 në të jetojnë 1,817 banorë. Nga objektet e standardit shoqëror fshati ka shkollën 9-vjeçare, stacionin shëndetësor dhe disa njësi tregtare dhe shërbyese. (Bajram Kafexholli)

NOVOSELLA-MAXHUNI Sabri (1943-). Veprimtar i lëvizjes ilegale, ish-i burgosur politik. Lindi në Prishtinë. Qysh herët aktivizohet në organizatat ilegale që kundërshtonin pushtetin dhe sundimin jugosllav. Në vitin 1963 anëtarësohet në Lëvizjen Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve (LRBSH). Ishte njëri nga organizatorët e demonstratave të vitit 1968. Më 1977, së bashku me verpimtarë të tjerë, themeloi Lëvizjen Nacionale për Çlirimin e Kosovës (LNÇK). Për aktivitetin e tij politik dhe kombëtar u dënua më burg dy herë: herën e parë me nëntë vjet heqje lirie, herën e dytë

me dy vjet. Për shkak të aktivitetit në lëvizjen ilegale, në fillim të viteve '80 u detyrua ta braktisë Kosovën dhe të emigrojë jashtë vendit, një herë në Turqi dhe më pas në shtetet e Europës Perëndimore. Për njëzet vjet të qëndrimit në emigrim ishte në ballë të aktiviteteve politike dhe demonstratave të emigracionit kosovar në vende të ndryshme të Europës Perëndimore. Në vitet 1998-1999 ndihmoi dhe e mbështeti materialisht luftën e UÇK-së, si dhe strehoi shumë refugjatë shqiptarë të Kosovës, që aso kohe kishin kaluar në Shqipëri, përkatësisht në Durrës. Me shkrimet dhe publikimet e tij u angazhua në trajtimin e temave të ndryshme me karakter kombëtar. Deri më tani ka botuar një sërë librash për lëvizjen ilegale në Kosovë, si dhe shumë shkrime në gazeta dhe revista të ndryshme. (Izber Hoti)

NOVSHAK France (France Novšak) (1916-1991). Gazetar, shkrimtar, leksikograf sloven. Studioi në Lubjanë dhe Beograd për drejtësi. Nisi punën në gazetari menjëherë pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore dhe mbulonte kulturën në gazeta si "Ljubljanski dnevnik" dhe "Delo", deri më 1975. U mor edhe me letërsi. Në vitet e fundit të jetës u mor me leksikografi. Hartoi Fjalorin slovenisht-maqedonisht (1982) dhe Fjalorin slovenisht-shqip (1988) me mbi 25,000 fjalë. Ka lënë në dorëshkrim edhe Fjalorin shqip-slovenisht. Novshak ishte invalid, me duar të amputuara dhe punonte me makinë shkrimi, të përshtatur enkas për gjendjen e tij. (Mensur Vokri)

NUHIU Hevzi (1956-) Skulptor. Lindi në Preshevë. Kreu shkollën fillore dhe gjimnazin në vendlindje, ndërsa studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Akademinë Pedagogjike të Shkupit. Nga viti 1983 jeton e vepron në Shën Mitër Korona të Kozencës, në ngulimin e njohur arbëresh në Itali. Hapi disa ekspozita personale dhe mori pjesë në disa të tjera kolektive. Për artin e tij u shkrua në revista të rëndësishme të artit dhe u vlerësua me çmime "Premio Calabria Produce" (1990) dhe me çmimi "Skanderbeg" (1993). Tek ai gjejmë shprehje metaforike, duke e shkrirë femrën në lis dhe lirin sërish në njeri, duke krijuar skena dramatike, tragjike, por edhe satirike, me gjestikulacione të formave tredimensionale të lira në hapësirë, të cilat japin frymë, emocion dhe kënaqësi. (Irir Muharremi)

NUHIU Nehat (1970-). Gazetar i sportit. Lindi në Gjilan. Me gazetari filloi të merret prej vitit 1999, fillimisht si redaktor i sportit në Radio "Viktoria" në Gjilan. Në periudhën 2001-2004 punoi redaktor i sportit në TV "Men", duke bërë edhe komentimin e ndeshjeve sportive. Më 2004 kaloi në RTV 21, kur për disa muaj punoi si gazetar i sportit, më pas u bë korrespondent i sportit i Radio-Kosovës nga Gjilani. Për Radio-Kosovën ka raportuar edhe në ndeshjet me karakter ndërkombëtar, si nga Shqipëria, Maqedonia e Turqia. (Enver Sadiku)

NUHIU Vesel (1938-). Gjuhëtar, përkthyes. Lindi në Kurbali të Preshevës. Kreu shkollën normale në Shkup, studimet universitare në Prishtinë, ndërsa studimet pasuniversitare në Zagreb. Në Prishtinë doktoroi me temën "Ndikimi i anglishtes në shqipen e Bostonit e të rrethinës" (The Impact of English on the Albanian Language in Boston and Its Environs). Një kohë punoi si mësues në Pirok të Tetovës, arsimtar i anglishtes në Kumanovë, gazetar i Radio-Prishtinës, katalogues në Bibliotekën Krahinore e Universitare të Prishtinës, përkthyes i anglishtes dhe koordinator i informimit në Kuvendin dhe Qeverinë Krahinore të Kosovës. Në Fakultetin e Filologjisë, në degën e anglishtes, punoi gjatë periudhës 1968-2003. Ishte edhe prodekan dhe dekan i Fakultetit të Filologjisë. Botoi artikuj që lidhen me kontrastime të shqipes dhe të anglishtes dhe disa tekste universitare nga fusha e gjuhësisë (për sintaksën dhe fonologjinë, të shkruara në gjuhën angleze), një monografi për fshatin e vendlindjes, një përmbledhje të punimeve nga fusha e ndikimeve gjuhësore të quajtur "Ndikimet ndërgjuhësore" (1990), Fjalor shprehesh frazeologjike anglisht-shqip (1990) etj. Ka përkthyer veprën e Eduard Sapirit "Gjuha". Monografia e tij "Ndikimi i anglishtes në gjuhës shqipe" u botua nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës më 2013. (Lindita Rugova)

NULI Xhafer (1947-). Inxhinier i elektroteknikës, mësimdhënës universiteti. Lindi në Zasellë, komuna e Mitrovicës. Kreu gjimnazin në Mitrovicë (1968), ndërsa studimet nga lëmi i elektroenergjetikës në Fakultetin Teknik të Universitetit të Prishtinës (1974). U punësua në minierën e Stantërgut në "Trepçë", ku, me ndërprerje, punoi deri në pensionim (2012).

Ishte drejtor teknik dhe drejtor për mirëmbajtje në minierën e Stantërgut për disa mandate. Udhëhoqi shumë projekte të rëndësishme të investimeve kapitale dhe punoi në komisione e grupe profesionale për hartimin dhe implementimin e programeve investuese të kombinatit “Trepça”. Në periudhën 1995-2005 ishte ligjërues në Fakultetin e Shkencave Aplikative në Mitrovicë. Nga viti 1990 deri në vitin 2000 udhëhoqi Sindikatën e Minatorëve të Stantërgut. (Isuf Krasniqi).

NUMIZMATIKA. Shkencë ndihmëse e historisë, e cila studion dhe interpreton monedhat që nga paraqitja e tyre. Shkëmbimi i mallrave më parë është bërë përmes tregtisë natyrale (mall për mall), andaj paraqitja e monedhave është bërë lehtësi e madhe në komunikimet tregtare. Prerjet e para të monedhave i atribuohen Mbretërisë së Lidisë, e cila nisi prerjen e tyre në shek. VII p.e.r. Më pas monedha prenë edhe qytet-shtetet antike të Greqisë, Maqedonia, ilirët, keltët etj. Monedhat simbolizojnë shtetin, identitetin dhe fuqinë e tij. Këto janë edhe vepra arti. Në faqe (avers) janë paraqitur kryesisht sundimtarët apo anëtarët e familjeve të tyre, kurse në shpinë (revers) një repertor i gjerë i veprave arkitektonike, hyjve, personifikimeve, glorifikimeve etj. Të drejtën për prerjen e monedhave, sidomos të atyre prej ari dhe argjendi, e kishin kryesisht sundimtarët. Në bazë të paraqitjeve realiste në faqe dhe shpinë janë identifikuar shumë objekte arkitektonike dhe skulptura të perandorëve dhe të anëtarëve të familjeve të tyre. Për nevoja të Perandorisë Romake, pos në Romë, janë hapur edhe vendfarkime të tjera, siç ishin ato në Lugdunum, Siscia, Sirmium etj. Në Dardani janë zbuluar monedha të periudhave të ndryshme, ndërsa Kosova ka koleksion të pasur numizmatik. (Fatmir Peja)

NURA Adem (1955-). Mësimdhënës universitar. Lindi në Dashec të Skënderajt. Shkollimin fillor dhe të mesëm i kreu në Mitrovicë, ndërsa Fakultetin e Mjekësisë në Universitetin e Prishtinës. Kreu studimet pasuniversitare në Tiranë, ku mbrojti edhe tezën e doktoratës nga fusha e shëndetësisë publike. Specializoi në lëmin e infektologjisë në Prishtinë dhe në Zagreb. Në vitin 2009 u zgjodh mësimdhënës në Fakultetin e Shkencave Sportive për lëndët anatomi funksionale dhe mjekësi sportive. Në vitin 2014 u emërua drejtor i Qendrës

Kombëtare të Mjekësisë Sportive. Bëri vizita të ndryshme studimore në institute mjekësore të vendeve të ndryshme dhe mori pjesë në konferenca të ndryshme shkencore. (Xhavit Kajtazi)

NURA Adem (1967-). Mjek, luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Lindi në Prelloc të komunës së Skënderajt. Në vitin 1988 shkoi në shërbimin ushtarak jugosllav në Slloveni, por pas pak javësh u arratis. Që në fillim bënte pjesë në grupet guerile të luftës çlirimtare në Kosovë. Ishte pjesëmarrës në luftimet e 30 dhjetorit të vitit 1991, kur forcat serbe sulmuan familjen Jashari. Më 1992 shkoi në Shqipëri për furnizim me armatim. Gjatë kthimit, në trekufirin Shqipëri-Kosovë-Maqedoni u arrestua nga patrulla kufitare maqedonase, të cilat më pas e dorëzuan te policia serbe në Han të Elezit, e cila e torturoi rëndë. Pas shërimit disamujor, mori pjesë në një sërë aksionesh kundër forcave serbe në maj të vitit 1993. Për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore, u detyrua të shkonte për shërim në Zvicër, ku e vazhdoi aktivitetin në logjistikën e UÇK-së. (Sabit Sylja)

NURA Avni (1974-). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Lindi në fshatin Prelloc të komunës së Skënderajt. Kreu shkollën mesme në Skënderaj, ndërsa studimet për menaxhment dhe informatikë në Universitetin e Prishtinës. Që në fillim të viteve '90 u inkadrua në grupet e para të luftës çlirimtare në Kosovë. Në shtator të vitit 1993, gjatë një rrethimi të forcave policore serbe u arrestua bashkë me disa familjarë të tij. Duke qenë i ndjekur nga pushteti serb, një kohë u strehua në Shqipëri. Më 16 shtator 1996 në një pusi të policisë serbe u arrestua dhe më pas për dy muaj u torturua në bazën e njësisë speciale policore në Hajvali të Prishtinës. Në korrik 1997, në procesin e gjykatës serbe në Prishtinë kundër 15 luftëtarëve, të njohur si “pesëmbëdhjetëshja e Drenicës”, A. Nura u dënua me 4 vjet burg. Pas vuajtjes së një pjese të dënimit, u lirua dhe iu bashkua radhëve të UÇK-së. Ishte pjesëmarrës në betejën e Qirezit dhe Likoshanit (28 shkurt 1998). Në prill 1998 u plagos gjatë luftimeve me forcat serbe, por nuk u largua nga fronti i luftës. Pas shërimit u kthye sërish në frontet e luftës deri në përfundim të saj. (Sabit Sylja)

NURA Elmaze (1978-). Regjisore, mësimdhënëse. Lindi në Skënderaj. Shkollimin fillor dhe të mesëm i kreu në Skënderaj, ndërsa studimet për regji të teatrit në Fakultetin e



ELMAZE NURA

Arteve të Universitetit të Prishtinës (2009). Bëri regjinë e një sërë shfaqjeve në teatrot e Kosovës, si “Lisistrata” (2012), “Çifti i hapur” (2012), “Ku...çka” (2013), “Amok” (2014), “Mbreti Ibi” (2016) etj. Me shfaqjet e saj mori pjesë në disa festivale teatrore brenda dhe jashtë vendit. Në disa nga këto festivale shfaqjet e saj kanë marrë çmime, si në Festivalin Ndërkombëtar të Dramës në Bishkek (2014, Kirgistan) dhe në Festivalin Ndërkombëtar të Dramës në Manastir (2014, Maqedoni), pastaj në disa festivale teatrore në Kosovë etj. Që nga viti 2012 E. Nura është sekretare e përgjithshme e Qendrës së Kosovës të Institutit Ndërkombëtar të Teatrit (ITI), ndërsa ishte drejtoreshë e Teatrit Kombëtar të Kosovës për disa muaj (2013). Është mësimdhënëse e lëndës regji teatri në Fakultetin e Arteve në Prishtinë. (Visar Krusha)

NURA Jakup (1966-). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Lindi në Prelloc të komunës së Skënderajt. Kreu Shkollën e Lartë Pedagogjike në Gjakovë. Që në rininë e hershme u përfshi në aktivitetet ilegale dhe më 1984 u dënua për veprimtari politike. Nga viti 1991 bënte pjesë në grupin e luftëtarëve të Adem Jasharit. Ishte pjesëmarrës në luftimet e zhvilluara më 30 dhjetor 1991, kur forcat serbe sulmuan familjen Jashari. Më pas mori pjesë në aksionet e armatosura kundër forcave policore serbe më 1992 dhe 1993. Në rrethanat e përndjekjes së vazhdueshme, në vitin 1994 emigroi në Gjermani. Në korrik të vitit 1997 gjykata serbe në Prishtinë e dënoi me 20 vjet burg në mungesë. Pas kthimit në Kosovë u angazhua për organizimin e njësiteve të UÇK-së në zonën e Drenicës dhe më gjerë. Mori pjesë në betejat që u zhvilluan në mbrojtjen e pikës luftarake në Fabrikën e Ferronikelit dhe Çikatovës, në mbrojtjen e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së në Likoc, si dhe në luftimet në Rrezallë dhe Polac. U plagos në korrik të vitit 1998 dhe më pas edhe në luftimet

në Duboc në shtator të vitit 1998. Në Brigadën 114 “Fehmi Lladrovci” ishte shef i operativës dhe më pas zëvendëskomandant i kësaj brigade. Pas luftës kreu detyra me përgjegjësi në Trupat Mbrojtëse të Kosovës dhe në Forcën e Sigurisë së Kosovës. (Sabit Sylja)

NURA Kastriot (1960-). Piktore. Lindi në Gjakovë. Kreu shkollimin fillor dhe të mesëm në Gjakovë, ndërsa Akademinë e Arteve (dega e pikturës) në Prishtinë. Nga fillimi i viteve ‘90 jeton në Oslo të Norvegjisë, ku ka zënë punë në fillim arsimtar i artit figurativ, ndërsa më vonë në një muze. Në një ekspozitë të përbashkët në Beograd (1985), mori çmimin për pikturë. Motivët e tablove i merr nga jeta e përditshme, i frymëzuar veçanërisht nga vendlindja. Në pikturën e tij vërehet një qasje bashkëkohore, mbështetur mbi surrealizmin universal. Prej kohësh preokupim e ka ciklin “Fati në blojë të mullinjve”, ku me përkushtim paraqet mbijetesën e individit dhe të kolektivit. Mulliri si simbol unik i ekzistencës bëhet udhërrëfim estetik i artistit. (Blerim Luzha)

NURA Vesta (1956-). Piktore. Lindi në Gjilan. Mbaroi shkollimin fillor dhe të mesëm në Prishtinë. Kreu Akademinë e Arteve (drejtimi i pikturës) në Prishtinë në vitin 1979. Nga viti 1980 deri më 2002 punoi si gazetare në të përditshmen “Rilindja” (më vonë “Bujku”), duke shkruar për artet pamore (kritika, recensione, intervista me artistë etj). Shkroi edhe për arkeologji dhe trashëgimi kulturore. Nga viti 2000 është koordinatore e arteve pamore në Ministrinë e Kulturës të Kosovës, ku punon edhe aktualisht. Në periudhën 2000-2012 ishte udhëheqëse e Galerisë së Ministrisë së Kulturës (Galeria “Qafa”). Vazhdon të merret me pikturë, ndërsa vokacioni i saj është portreti. Mori pjesë në shumë ekspozita kolektive. (Blerim Luzha)

NURA Xajë (1934-2017). Shkrimtar, i burgosur politik. Murteza Nura, i njohur si Xajë Nura, lindi në Pejë. Kreu shkollimin fillor dhe të mesëm në vendlindje, ndërsa studimet për drejtësi i ndoqi në Universitetin e Prishtinës. Pjesën më të madhe të jetës e kaloi në Gjakovë. Krahas poezisë dhe prozës, u mor edhe me pikturë. Botoi një sërë veprash letrare, disa prej të cilave janë: “Maratona e prerë” (1993), “Shtesë shqipe” (1993), “Aktrimi i frymës”

(1993), “Heshtja e biblave” (1994), “Dita e vrasjes” (2004), “Klithja e metaforës” (2004), “Një jetë ndryshe” (2004), “Jam Udha e Virtytit” (2009), “E vërteta vjen virgjër” (2010), “Dëshmorin nuk e do harrimi” (2012). X. Nura për një kohë të gjatë ishte i mënjanuar nga jeta letrare, si kundërshtar i vendosur i pushtetit jugosllav në Kosovë. Ishte i dënuar një herë me tetë vjet burg, herën dytë me nëntë dhe herën e tretë me katër vjet heqje lirie. Poezia dhe proza e tij mbeten dëshmi e një jete të ëndërruar, të vvarë, të pajetuar. Një botë me motive të tilla bartin edhe pikturat e tij. Motivet dhe frymëzimet e artit të tij poetik e piktural e shfaqin autorin si një rebel të përhershëm kundër tiranisë dhe dhunës. (Kujtim Rrahmani)

NURAJ Bajram (1954-). Mjek, anatomist, profesor universiteti. Lindi në Rracaj të Gjakovës, shkollën fillore e kreu në Sheremet, ndërsa të mesmen në Deçan. U diplomua në Fakultetin




BAJRAM NURAJ

e Mjekësisë në Prishtinë (1980). Mbaroi studimet pasuniversitare në Fakultetin e Mjekësisë në Zagreb, ndërsa më 1987 mbrojti tezën e doktoratës po në Universitetin e Zagrebit. Së pari punoi si asistent në Institutin e Anatomisë në Fakultetin e Mjekësisë në Universitetin e Prishtinës (1981), pastaj u zgjodh docent, profesor inordinar dhe më 1999 profesor ordinar i lëndës së anatomisë. Pas luftës u emërua zëvendësues i Departamentit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale të Kosovës (2000-2002). Në periudhën 2004-2006 ishte dekan i Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës. Në periudhën 2013-2015 ishte rektor themelues i Universitetit të Gjakovës “Fehmi Agani” dhe kryetar i këshillit për themelim. Ka marrë pjesë në shumë kongrese e simpoziume shkencore në vend dhe në botën e jashtme dhe është autor dhe bashkautor i një sërë punimesh shkencore e profesionale. Është autor i tri teksteve universitare për lëndën e anatomisë (koka dhe qafa, sistemi nervor periferik, kombliku). Është profesor i rregullt në Institutin e Anatomisë në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. (Ibrahim Behluli, Agim Vela)

NUREDINI Beqir (1950-). Aktor. Lindi në fshatin Kondovë të Shkupit, ku e kreu shkollën fillore. Nga viti 1984 punësohet si aktor profesionist në Teatrin e Kombësive në Shkup. Luajti në një sërë rolesh në teatër dhe në film, si në gjuhën shqipe, po ashtu edhe maqedonase, rome e turke. Si aktor ka qenë i pranishëm në skenë veçanërisht në vitet ‘80. Ka luajtur role edhe në filma të realizuar në hapësirat e ish-Jugosllavisë, kryesisht në kinematografinë kroate, por edhe në atë spanjolle dhe të disa vendeve të Amerikës Latine. Ndër rolet më të realizuara janë edhe ato në shfaqjet për fëmijë: “Frika e miut” dhe “Pinoku”, si dhe në shfaqjen “Kaligula”. Është aktor i Teatrit Shqiptar në Shkup. (Salajdin Salihu)

NUREDINI Sefedin (1953-2017). Aktor, mësimdhënës universiteti. Lindi në Kumanovë, ku kreu shkollën fillore dhe të mesme, ndërsa studimet për aktrim i përfundoi në Fakultetin



SEFEDIN NUREDINI

e Arteve Dramatike të Universitetit të Shkupit (1977). Realizoi një sërë rolesh në shfaqjet: “Gof” me regji të A. Jakupit, “Nita” të S. Fankos, “Zbutësi i njerëzve” të A. Jakupit, “Shi në Uertemonto” dhe “Pahintikë në ëndërr” me regji të V. Millçin-it), “Vojceku” me regji të B. Brezovac-it, “Zeka i Zi udhëton për Babilon” e F. Hysajt, “Korb mes egërsirash” të A. Sopit, “Hamleti” të A. Jakupit, “Të shpëtojë shpresa” të M. Stefanovsk-it; “Kuçedra” me regji të Sh. Nuredinit etj. Ka aktruar në filmat: “Nata” nga E. Musliu, “Kolonel Bunker” nga K. Çashku, “Babai im” dhe “Kultivuesit e duhanit” nga Sh. Nuredini, “Përralla” nga S. Aliu etj. Është fitues i disa çmimeve. Dy herë u shpall aktori më i mirë i Festivalit teator “Vojdan Çernodrinski” në Prilep dhe u nderua me çmimin “Aleksandër Moisiu”, si aktori më i mirë i Festivalit Mbarëkombëtar në Tiranë më 1994. Ka qenë drejtor i Teatrit të Kombësive në Shkup, njëri ndër themeluesit dhe dekan i Fakultetit të Arteve në Universitetin e Tetovës dhe udhëheqësi i klasës së parë të aktrimit. Ka qenë pjesë e trupës teatrore të Teatrit Shqiptar të Shkupit. (Salajdin Salihu)

NUREDINI Vaxhid (1946-). Pedagog, mësimdhënës universiteti. Lindi në Rahovicë,

komuna Preshevës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, gjimnazin në Preshevë, studimet e pedagogjisë në Fakultetin Filozofik të Prishtinës. Magjistroi më 1980 dhe doktoroi më 1987 në Fakultetin Filozofik të Zagrebit. Fillimisht ishte mësues i shkollës fillore, pastaj mësime në gjimnazin e Preshevës. Nga viti 1983-1991 ishte këshilltar pedagogjik në Prishtinë, pastaj mësime në Shkollën e Lartë Pedagogjike të Prizrenit dhe në Fakultetin e Edukimit në Prishtinë. Botoi punime në revista vendore e ndërkombëtare dhe disa vepra të veçanta nga fusha e pedagogjisë dhe e metodikës: “Orientimi profesional i nxënësve” (1989), “Metodika e punës së pedagogut të shkollës” (1990), “Teoria e mësimit” (2005), “Bazat e metodikës së punës edukative” (2002), “Teknologjia e mësimit” (2004), “Edukata parashkollë” (2012) etj. (Januz Dervodeli)

NUSHI Bardhyl (1939-2015). Trajner i basketbollit. Karrierën sportive e filloi si boksier, ndërsa më pas ai u bë njëri prej trajnerëve më të suksesshëm të basketbollit kosovar dhe punëtor i dalluar sportiv i Kosovës. Ka qenë trajner i brezit të artë të KB “Prishtina” dhe vlerësohet si më i merituari për zhvillimin e basketbollistëve vendorë në vitet ’70 dhe ’80 në Kosovë. Ishte themelues i KB “Gjimnazisti”, më pas “Elektricitisti”, “Elektroekonomia”. KB “Prishtina”, e prirë nga B. Nushi ka luajtur në kualifikime për Ligën e parë federative të ish-Jugosllavisë, në stinorin 1976/77. Më pas ishte trajner i “Vëllaznimit” në Ligën e parë B të ish-Jugosllavisë. Një kohë ishte edhe gazetar i sportit në Televizionin e Prishtinës. Është autor i librit “Basketbolli bashkëkohor”. (Albatrit Matoshi)

NUSHI Jakup (1938-1999). Inxhinier i gjeologjisë, profesor universiteti. Lindi në Gjakovë, shkollën fillore dhe të mesmen i kreu në Gjakovë, studimet në Fakultetin e Xehetarisë-Gjeologjisë dhe të Naftës në Universitetin e Zagrebit (1964). Studimet pasuniversitare i kreu në Fakultetin e Xehetarisë dhe të Gjeologjisë të Universitetit të Beogradit, ndërsa disertacionin e mbrojti në Fakultetin e Xehetarisë dhe të Metalurgjisë të Universitetit të Prishtinës (1990). Fillimisht punoi në minierën e kromit “Deva” në Gjakovë (1964-1976) si inxhinier i gjeologjisë. Aktivitetin pedagogjik e filloi si ligjërues në Fakultetin e Xehetarisë dhe të Metalurgjisë të Universitetit të Prishtinës (1976) dhe më pas

mori titujt përkatës universitarë. Është autor dhe bashkautor i disa punimeve shkencore dhe profesionale nga lëmi i gjeologjisë. U vra nga forcat serbe në shtëpinë e tij në Gjakovë në prill të vitit 1999. (Shyqeri Kelmendi)

NUSHI Menduh (1953-). Xhirues, drejtor fotografie, mësime në universiteti. Lindi në Pejë, ku kreu shkollën fillore dhe të mesme. Studimet për kamerë filmike i kreu në Akademinë



MENDUH NUSHI

për Teatër, Film dhe TV në Zagreb. Është mësime në Fakultetin e Arteve në Prishtinë, ku ligjëron lëndën fotografi dhe fotografi filmike. Xhironi dhjetëra filma dokumentarë e artistikë. Shquhet me stil të veçantë të kuadrin të estetizuar. Ishte drejtor i fotografisë në disa filma të metrazhit të gjatë artistikë dhe dokumentarë. Xhironi filmat: “Fytyrë dheu”, “Njeriu prej dheu”, “Pikniku”, “Rojat e mjegullës”, “Kur shpirti ndërron jetë”, “Muzgu i tokave tona”, “Kukumi”, “Agnus Dei”. Përveç fotografisë e filmit, e ka vokacion edhe fotografinë artistike dhe dokumentare, me të cilat mori pjesë në ekspozita të shumta brenda dhe jashtë vendit. U mor edhe me fotoreprodukimin e pikturave dhe të punimeve të tjera artistike, si dhe të katalogëve e monografive. Në profilin e drejtorit të fotografisë u cilësua si ndër më të mirët në ish-Jugosllavi. Fotografinë e tij e karakterizon mjeshtria e lartë e xhirimit, poetizimi dhe simbolika. (Gani Mehmetaj)

NUSHI Pajazit (1933-2015). Psikolog, profesor universiteti, akademik. Lindi në Gjakovë, ku kreu shkollën fillore dhe të mesme. U diplomua në katedrën e psikologjisë në Fakultetin



PAJAZIT NUSHI

shqipe”. Nga viti 1956 deri në vitin 1995 punoi si profesor i psikologjisë në Shkollën

për Teatër, Film dhe TV në Zagreb. Është mësime në Fakultetin e Arteve në Prishtinë, ku ligjëron lëndën fotografi dhe fotografi filmike. Xhironi dhjetëra filma dokumentarë e artistikë.

Shquhet me stil të veçantë të kuadrin të estetizuar.

Ishte drejtor i fotografisë në disa filma të metrazhit të gjatë artistikë dhe dokumentarë. Xhironi filmat: “Fytyrë dheu”, “Njeriu prej dheu”, “Pikniku”, “Rojat e mjegullës”, “Kur shpirti ndërron jetë”, “Muzgu i tokave tona”, “Kukumi”, “Agnus Dei”. Përveç fotografisë e filmit, e ka vokacion edhe fotografinë artistike dhe dokumentare, me të cilat mori pjesë në ekspozita të shumta brenda dhe jashtë vendit. U mor edhe me fotoreprodukimin e pikturave dhe të punimeve të tjera artistike, si dhe të katalogëve e monografive. Në profilin e drejtorit të fotografisë u cilësua si ndër më të mirët në ish-Jugosllavi. Fotografinë e tij e karakterizon mjeshtria e lartë e xhirimit, poetizimi dhe simbolika. (Gani Mehmetaj)

NUSHI Pajazit (1933-2015). Psikolog, profesor universiteti, akademik. Lindi në Gjakovë, ku kreu shkollën fillore dhe të mesme. U diplomua në katedrën e psikologjisë në Fakultetin

Filozofik të Universitetit të Beogradit më 1955. Studimet e larta i finalizoi me mbrojtjen e tezës së disertacionit të doktoratës në terminologjisë psikologjike dhe baza semantike e përcaktimit të saj në gjuhën

shqipe”. Nga viti 1956 deri në vitin 1995 punoi si profesor i psikologjisë në Shkollën

Normale të Prishtinës, më pas në Shkollën e Lartë Pedagogjike të Prishtinës, e pastaj edhe profesor i psikologjisë në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës dhe në Universitetin e Tetovës. Krahas mësimdhënies ka ushtruar funksione të ndryshme në institucionet e Kosovës, siç ishte nënkryetar i Këshillit Ekzekutiv të KSA të Kosovës, ndihmëskryetar i Këshillit Federativ për Arsim e Kulturë të ish-Jugosllavisë. Së voni ishte kryetar i Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriu në Prishtinë. Në vitin 2000 u zgjodh anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, ndërsa në vitin 2008 anëtar i rregullt i saj. Ka qenë kryetar i Shoqatës së Psikologëve të Kosovës dhe nënkryetar i Shoqatës Mbarëshqiptare të Psikologëve. Në vitin 2011 është shpallur "Nderi i qytetit të Gjakovës" dhe po atë vit u zgjodh këshilltar i lartë shkencor në Institutin e Hulumtimeve të Krimeve të Luftës në Kosovë dhe nënkryetar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Ishte bartës i disa dekoratave dhe i mirënjohjeve. P. Nushi botoi një sërë veprash nga fusha e psikologjisë: "Bazat psikologjike të kulturës së të folurit të nxënësve të shkollës fillore" (1964), "Fjalor i psikologjisë" (1987), "Orientimi profesional dhe individualiteti psikofiziologjik i zgjedhësve të profesionit" (2004), "Inteligenca dhe masat e zhvillimit të saj ndër shqiptarët e moshës madhore" (2006), "Çështja shqiptare dhe integritet politik, ekonomike (Kërkimet teorike empirike)" (2003), "Kujtesa dhe trajtimi i saj në literaturën shqipe nomotike" (2008), "Psikanaliza dhe mendimi psikologjik shqiptar" (2006), "Fjalor shpjegues i psikanalizës" (2010) etj. Gjithashtu është autor i teksteve shkollore të psikologjisë dhe i disa teksteve universitare ("Psikologjia e përgjithshme" I dhe II, "Njeriu dhe personaliteti i tij në psikologji"), si dhe ka përkthyer disa tekste mësimore. Aktiviteti profesional dhe shkencor i P. Nushit përfshin fushat studimore të psikologjisë së përgjithshme, të terminologjisë së psikologjisë, të psikologjisë pedagogjike, të etnopsikologjisë dhe të metodologjisë hulumtuese të psikologjisë. Me kumtesa dhe punime shkencore mori pjesë në shumë simpoziume, tryeza dhe konferenca shkencore. (Kaltrina Kelmendi)

NUSHI Salih (1929-2002). Mësimdhënës universiteti, veprimtar i arsimit. Lindi në Mitrovicë, ku kreu shkollën fillore, shkollën normale e kreu në Gjakovë, ndërsa studimet për pedagogji në Fakultetin Filozofik në Beograd. Pas Luftës së Dytë Botërore punoi shumë për arsimin në Kosovë. Ishte mësimdhënës dhe drejtues shkollash në Kosovë dhe zyrtar i arsimit e i kulturës. Një kohë ishte mësimdhënës dhe drejtor i shkollës ekonomike në Mitrovicë, drejtor shumëvjeçar në Normalen e Prishtinës, ligjërues në katedrën e pedagogjisë të Fakultetit Filozofik në Prishtinë. Ndërkohë ishte edhe shef i Sektorit të Arsimit dhe deputet në Dhomën Arsimore-Kulturore të Kuvendit Federativ të Jugosllavisë, përfaqësues i Kosovës në organe e forume të Federatës Jugosllave. Në vitin 1981 u emërua kryetar i Komitetit të Arsimit, Shkencës dhe të Kulturës të Kosovës. Që herët u angazhua në publicistikën pedagogjike në revistën "Përparimi" dhe në revista të tjera. Për kontributin e tij në fushën e arsimit dhe të kulturës S. Nushit iu dhanë mirënjohje dhe dekorata. (Afërdita Deva-Zuna)

NUSHI Violeta (1965-). Inxhinieri e arkitekturës, profesore. Lindi në Gjakovë, ku kreu shkollën fillore e të mesme. Kreu studimet në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe të Arkitekturës në Universitetin e Prishtinës, ku më vonë përfundoi edhe studimet pasuniversitare (2004). Studimet e doktoratës i përfundoi në Universitetin Politeknik të Tiranës (2007). Në vitin 2003 u zgjodh asistent, më pas asistent profesor (2010) në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe të Arkitekturës. Si autore dhe bashkautore botoi disa studime me recension ndërkombëtar për mbrojtjen e godinave historike dhe për ndërtimin e qëndrueshëm. Është marrë me hulumtime shkencore në kuadër të "COST TU 0901" (integrimi dhe harmonizimi i izolimit zanor në vendbanimet dhe ndërtimet e qëndrueshme urbane, 2009-2013), "COST TU 0905" (qelqi strukturor, metodat e dizajnit bashkëkohor dhe produktet e reja, 2010-2014) etj. Ka marrë pjesë në shumë konferenca shkencore brenda dhe jashtë vendit. (Dervish Qerreti).

NJ

NJËSITET E ARMATOSURA TË LËVIZJES ANTIFASHISTE NACIONALÇLIRIMTARE NË KOSOVË (1941-1944). Që në verën e vitit 1941, komunistët kosovarë të përfshirë në Partinë Komuniste të Jugosllavisë filluan organizimin grupeve guerile për luftë kundër pushtuesit. Aksioni i përhershëm i këtyre grupeve në Kosovë ishte minimi i teleferikut për bartjen e xeheve ndërmjet Trepçës dhe Zveçanit, afër Mitrovicës, që u bë nga gjysma e korrikut të vitit 1941. Ky grup minatorësh e komunistësh serbë disa ditë më vonë formuan Aradhen e Kopaonikut. Grupe diversantësh, një vit më vonë, u formuan edhe në anë të tjera të Kosovës. Më 27 shtator të vitit 1942 në fshatin Ramjanit të Vitisë u formua Aradhja e “Zenel Hajdini” me partizanë shqiptarë. Kjo aradhe më 3 janar 1943, në Carralevë, në rrugën Prishtinë-Prizren sulmoi një kolonë karabinierësh italianë dhe vrau njëzet vetë dhe komandantin e tyre. Nga dy batalione të Ferizajt me rrethinë dhe tri batalioneve të Zhupës së Sirinikut, në tetor të vitit 1942 u formua aradhja e prapavijës e LNÇ-së, ndërsa në Kallagjuricë më 3 janar 1942 u formua Ardhja e Sharrit, kryesisht me luftëtarë serbë të fshatrave të kësaj ane dhe një numër të vogël komunistësh shqiptarë. Në muajin dhjetor të po këtij viti ky njësit u shkapërderdh, por nga njerëzit e tij dhe nga disa maqedonas në Gërbule, afër Ferizajt, u formua Aradhja e Karadakut, që luftoi kundër pushtuesit bullgar. Në janar të vitit 1943, nga një pjesë e Aradhes “Zenel Hajdini”, në fshatin Vrellë afër Prishtinës, u formua Ardhja “Emin Duraku”. Në Malet e Sharrit, më 18 mars 1943 u formua sërish Aradhja e Sharrit, në radhët e së cilës u përfshinë luftëtarët e Aradhes “Emin Duraku”. Në fund të muajit prill të vitit 1943 u formua Shtabi Kryesor (Suprem) i Ushtrisë Nacionalçlirimtare (UNÇ) dhe i

Aradheve Partizane për Kosovë dhe Metohi (Dukagjin). Në vjeshtën e po atij viti u formuan batalioni partizan “Ramiz Sadiku” dhe “Boro Vukmiroviqi”, me afër njëqind luftëtarë të Aradhes së Sharrit dhe të të burgosurve politikë që kishin ikur nga llogoret italiane. Prej këtyre dy batalione më 22 tetor 1943 u formua grupi i batalioneve të Kosovës, që më pas hyri në përbërjen e Brigadën I Maqedone-Kosovare. Nga gjysma e vitit 1944 formimi i njësiteve të armatosura me luftëtarë nga Kosova, vullnetarë dhe rekrutë, u shpeshua, kështu që deri në fund të luftës në territorin e Kosovës, të Maqedonisë, të Shqipërisë dhe të Serbisë u formuan tetë brigada të aradheve partizane të UNÇ-së dhe një Brigadë e Korpusit të Mbrojtjes Popullore të Jugosllavisë (KNOJ). (Izber Hoti)

NJËSITET PARTIZANE TË KOSOVËS. Formacione të armatosura, të cilat vepruan në Kosovë gjatë Luftës Antifashiste Nacional-çlirimtare nga viti 1941 deri më 1944. U organizuan nga



NJËSIT PARTIZAN

anëtarët dhe simpatizantët e Partisë Komuniste të Jugosllavisë (PKJ). Sipas instruksioneve të Komitetit Qendror të PKJ-së, forma e parë e

organizimeve ishin komitetet ushtarake, të cilat kishin për detyrë të grumbullonin armë dhe të përgatitnin kuadrot ushtarake për formimin e njësiteve të armatosura. Aradhja e parë partizane në Kosovë ishte ajo e Kopaonikut, e cila u themelua në tetor 1941, me rreth 800 luftëtarë. Në tetor të vitit 1941, në rrethinën e Pejës u formua Aradhja Partizane e Metohisë, e cila kishte mbi 700 luftëtarë. Më 27 shtator 1942 formohet Aradhja partizane shqiptare “Zenel Hajdini”, e cila me rastin e formimit kishte 13 luftëtarë, me komandant Xheladin Kurbalium, zëvendëskomandant Pero Karaxhiqin dhe komisar politik Fadil Hoxhën. Më 6 janar 1943 aradhja ndahet në dysh, njëra që mbajti emrin e parë “Zenel Hajdini” me komandant Petar Brajoviqin, ndërsa njësitë tjetër mori emrin “Emin Duraku”, me komandant Fadil Hoxhën, nga e cila më 8 prill 1943 u formu Çeta partizane “Bajram Curri”. Më 9 maj 1943, prej partizanëve të kësaj aradhe si dhe të atyre nga Ferizaj, Prizreni, Srečka dhe viset e tjera përreth, formohet Aradhja e Sharrit me 200 luftëtarë. Nga të liruirit prej burgjeve të Shqipërisë, në Izvor afër Kërçovës, më 16 shtator 1943, formohet Batalioni i Parë Kosovar “Ramiz Sadiku” me 150 luftëtarë, ndërsa prej të internuarve në kampin Porto Romano afër Durrësit dhe prej atyre të burgut të Tiranës, më 20 shtator u formua Batalioni “Boris Vukmirovic” me 140 luftëtarë. Më 22 tetor 1943 në rajonin e Dibrës u formua Aradhja Nacionalçlirimtare Partizane e Kosovës dhe e Metohisë me 220 luftëtarë. Më 11 nëntor 1943, në fshatin Slivovë të Maqedonisë u formua Brigada e Parë Maqedono-Kosovare. Më 21 nëntor 1943 në Prohor Pçinjski afër Kumanovës, u formua Batalioni Kosovar më 66 luftëtarë, ndërsa më 29 dhjetor 1943 në Sllavnik të Lebanit formohet Batalioni i Dytë Kosovar me 110 luftëtarë. Më 25 mars në Vishevc të Vrajës u formu Aradhja Nacionalçlirimtare e Kosovës më 210 luftëtarë. Më 9 nëntor 1943 afër Kuksit, Çeta partizane “Bajram Curri” u shndërrua në batalion me të njëjtin emër dhe me Batalionin e Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Shqipërisë “Perlat Rexhepi”, më 12 janar 1944, u bashkuan në një aradhe dhe mori emrin Batalioni “Curri-Rexhepi” me 188 luftëtarë. Në qershorin e vitit 1944 formohet Batalioni “Kosova” me 90 luftëtarë, kurse në gusht të vitit 1944 u formua Aradhja Nacionalçlirimtare e Ibrit me 1000 luftëtarë. Në fundin e gushtit

të vitit 1944, në territorin e Shalës, u formua Aradhja Nacionalçlirimtare e Shalës dhe më 7 nëntor 1944 nga luftëtarët e kësaj aradhe dhe të Batalionit të Ibrit u formua Aradhja Nacionalçlirimtare e Kosmetit. Disa prej këtyre njësiteve u rritën në brigada të Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Jugosllavisë për Kosovë. Brigada I e Kosovës u formua në Zbrazhd afër Strugës më 24 qershor 1944, me gjithsej 292 luftëtarë. Në Lilanc të Bujanocit më 9 shtator 1944 u formu Brigada II Nacionalçlirimtare e Kosovës, me gjithsej 450 luftëtarë. Në Krajmiroc të Vrajës më 12 shtator 1944 formohet Brigada III Nacionalçlirimtare e Kosovës “Milan Zeçar” me 450 luftëtarë. Nga refugjatët nga Kosova dhe vullnetarët serbë, më 24 shtator 1944, në Tullare, afër Lebanit, formohet Brigada V Nacionalçlirimtare e Kosovës me 500 luftëtarë, kurse më 13 tetor të po atij viti në Krumë të Shqipërisë formohet Brigada IV Nacionalçlirimtare e Kosovës me 400 luftëtarë. Më 11 nëntor 1944 në Gjakovë u formua Brigada VII e Kosovës, Brigada VI e Kosovës u formua më 13 dhjetor 1944 në Mitrovicë, ndërsa Brigada VIII e Kosovës u formua më 20 dhjetor 1944 në Rakosh të Istogut me 2,000 luftëtarë. Përveç njësiteve të rregullta të UNÇ-së, në Kosovë formohen edhe njësitet partizane të prapavijës, si në Prishtinë, Prizren, Rahovec, Ferizaj, Gjakovë, Mitrovicë dhe në Gjilan. (Daut Bislimi)

NJOHJET NDËRKOMBËTARE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS. Proces i legjitimitetit ndërkombëtar të Kosovës dhe njëri ndër prioritetet e politikës së jashtme të vendit. Deri në fund të vitit 2016, Republikën e Kosovës e njohën 113 shtete anëtare të OKB-së, përfshirë tri anëtare të përhershme të Këshillit të Sigurimit (Franca, Mbretëria e Bashkuar dhe SHBA-ja), 23 shtete anëtare të BE-së (Austria, Belgjika, Bullgaria, Danimarka, Estonia, Finlanda, Franca, Gjermania, Holanda, Hungaria, Irlanda, Italia, Kroacia, Letonia, Lituania, Luksemburgu, Polonia, Malta, Mbretëria e Bashkuar, Portugalia, Republika Çeke, Sllovenia, Suedia), dhe 24 shtete anëtare të NATO-s. Prej shteteve fqinje, Kosovën e ka njohur Shqipëria, Maqedonia dhe Mali i Zi. Numri më i madh i njohjeve janë realizuar në vitin e shpalljes së pavarësisë (53), për t’u pasuar nga oscilime, por përgjithësisht me numër më të vogël të njohjeve në vitet vijuese. Në gusht

të vitit 2008 Serbia parashtrroi kërkesë në OKB për vlerësimin e ligjshmërisë së shpalljes së pavarësisë, akt për të cilin besohet të ketë ndikuar negativisht në procesin e njohjeve. Pas referimit të kërkesës nga Asambleja e Përgjithshme, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë në korrik 2010 vlerësoi se Deklarata e Pavarësisë së Kosovës nuk është në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare. Edhe pse shtetet përkras dhe autoritetet e Kosovës u angazhuan, pesë vende të BE-së vazhdojnë të mos e njohin pavarësinë e Kosovës (Greqia, Qiproja, Rumania, Sllovakia dhe Spanja). Ndonëse disa herë ishin paralajmëruar mundësi të ndryshimit të qëndrimit, një gjë e tillë nuk është realizuar ende dhe vazhdon të paraqesë pengesë serioze në procesin e përafrimit të Kosovës me BE-në. Krahas njohjes nga shtetet e pavarura, politika e jashtme e Kosovës është përqendruar në anëtarësim në organizata ndërkombëtare, si në Bankën Botërore, në Fondin Monetar Ndërkombëtar, në Bankën Europiane për Investime, në UNESCO (për 3 vota nuk arriti të anëtarësohej në vitin 2015). Kosova deri tani është anëtare e mbi 30 organizmave dhe forumeve rajonale. (Ilir Dugolli)

NJUMARK Leonard (Newmark) (1929-). Gjuhëtar, albanolog, profesor. U diplomua në Universitetin e Çikagos, ndërsa u doktorua në Universitetin e Indianës. Ishte mësimdhënës në Universitetin e Indianës në vitet 1951-1963 në nivele të ndryshme, deri në shkallën profe-



LEONARD
NJUMARK

sor i asociuar (1962). Nga viti 1963 profesor i gjuhësisë në Universitetin e Kalifornisë, shef i departamentit të gjuhësisë. Mbajti mësim dhe në Universitetin Shtetëror të Ohajos, në Universitetin e Miçiganit dhe të Illinoit. Është anëtar i Shoqatës së Fjalorëve të Amerikës së Veriut (Dictionary Society of North America) dhe i Shoqatës së Gjuhëtarëve të Amerikës. Botoi punime të shumta dhe libra për shqipen, një gramatikë të shqipes dhe një fjalor. Ndër botimet më të rëndësishme të tij janë: “Gramatika strukturale e shqipes” (Structural Grammar of Albanian, 1957); “Shqipja standarde: Gramatikë referenciale për studentët” (Standard Albanian: A Reference Grammar for Students”, bashkautorësi me P. Priftin dhe F. Habardin, 1982); “Fjalori shqip-anglisht i Oksfordit” (Oxford Albanian-English Dictionary”, 1998), “Shqipëria - Manual me fjalor anglisht dhe shqip” (Albania-Handbook with English and Albanian Glossaries”, në bashkautorësi me V. Dervishin, 1999). Konsiderohet ndër autorët më me ndikim për studimet e shqipes në Amerikë. Ndër veprat e tjera veçohet: “Hyrje gjuhësore në historinë e anglishtes” (A Linguistic Introduction to the History of English, në bashkautorësi me M. Blumfildin, 1963). Është anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. (Lindita Rugova)

O

OBILIQI (KASTRIOTI). Qytet në pjesën qendrore të Kosovës, rreth 6 km në perëndim të Prishtinës, pranë rrugës kryesore për Mitrovicë, në lartësi mbidetare 520 m. Si vendbanim



OBILIQI

përmendet në defterin kadastral të vilajetit Vëllk të vitit 1455 me emrin Klobodari me 7 shtëpi. Pas ndërtimit të hekurudhës Shkup-Mitrovicë në vitin 1873 bëhet qendër e njohur tregtare, sidomos për grumbullimin dhe shitjen e drithërave. Në kohën e sundimit osman ishte qendër e nahisë. Ndërmjet dy luftërave botërore formohet çarshia me dyqane në të dy anët e hekurudhës. Pas vitit 1952, me ndërtimin e termocentralit “Kosova A” ngrihen edhe kolonitë e punëtorëve për t’iu bashkëngjitur pastaj edhe familje të shumta nga rrethina. Përqendrimi i popullsisë dhe i objekteve të tjera industriale e shërbyese reflektoi në ngritjen dhe zhvillimin e shpejtë të qytezës. Në vitin 2011 kishte 6,864 banorë, ndaj 310 banorëve në vitin 1921. Qendra e qytetit është zhvilluar përgjatë bulevardit “Skënderbeu” dhe dy shesheve kryesore. Aty gjenden edhe objektet kryesore administrative të qytetit, si posta, shtëpia e kulturës, biblioteka, qendra e mjekë-

sisë familjare etj. Veprimtari primare është energjetika, me tendencë të zhvillimit të mëtejme të kapaciteteve të reja, me ndërtimin e bllokut të tretë “Kosova e re”. (Përparim Gashi)

OBILIQI (KASTRIOTI) (komuna). Komunë në pjesën qendrore të Kosovës, me qytetin në qendër me të njëjtin emër. Shtrihet në pjesën qendrore të Rrafshit të Kosovës në lartësinë mbidetare 568 m dhe me sipërfaqe 105 km². Në lindje kufizohet me komunën e Prishtinës, në perëndim me atë të Vushtrrisë dhe Drenasit, në jug me Fushë-Kosovën dhe në veri me komunën e Podujevës. Pjesa më e madhe është relief fushor. Në jug të lumit Sitnica ngrihet reliefi kodrinor-malor i Çiçavicës dhe në veri po ashtu vazhdon peizazhi kodrinor i maleve të Kopaonikut. Rreth 71% është tokë bujqësore, 17%, pyje, 9% zonë e ndërtuar dhe 3% zonë industriale. Lumenjtë kryesorë janë Sitnica me degët e saj Llapin dhe Drenicën, që i takojnë pellgut të Ibrit. Mbizotëron klima e mesme kontinentale. Megjithëse fushë e gjerë pjellore, e pasur me ujë që përshkohet nga tre lumenj, komuna e Obiliqit më tepër është e njohur për rezervat e mëdha të linjtit. Obiliqi kishte funksionin e nahisë qysh gjatë kohës së sundimit turk, kurse statusin e komunës e pati gjithashtu pas luftës së parë dhe të dytë botërore, gjithnjë deri në vitin 1962, kur u integrua në kuadër të komunës së Prishtinës. Më 1989 përsëri konsolidohet si komunë me 20 vendbanime. Pjesa dërrmuese e popullsisë është e përqendruar në zonën fushore. Në qytet jetojnë 1/3 e popullsisë së komunës. Veprimtaritë kryesore janë: energjetika, pastaj tregtia, hoteleria dhe shërbimet e tjera terciare. Zhvillimi i këtyre veprimtarive u mundësua falë resurseve, pozitës dhe linjave të rëndësishme rrugore e hekurudhore. Por eksploatimi i qymyrit dhe djegia e tij për

prodhimin e energjisë elektrike në dy termo-centralet “Kosova A” dhe “Kosova B”, grumbujt kolosalë të hirit dhe deponia sanitare e mbeturinave në Mirash paraqesin sfidë të madhe mjedisore jo vetëm për 20 vendbanimet e komunës, por edhe për rajonin qendror të Kosovës. Në vitin 2011 kishte 21,549 banorë, ndaj 9,228 banorëve në vitin 1948. (Përparim Gashi)

OBRADOVIQ (Obradović) Milovan (1933-). Historian, mësimdhënës universitar. Lindi në fshatin Dubovë të Belo Poles në Mal të Zi. Shkollën fillore e kreu në vendlindje ndërsa Shkollën Normale në Ivangrad (1954). Punoi mësues në Mal të Zi dhe arsimtar i historisë në Miloshevë në Kosovë. Studimet për histori i kreu në Fakultetin Filozofik në Shkup (1964). Më 1967 punësohet në Institutin e Historisë në Prishtinë. Studimet pasuniversitare i kreu në degën e historisë të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Beogradit (1975), ndërsa në Fakultetin Filozofik të Prishtinë mbrojti temën e disertacionit me titull “Reforma agrare dhe kolonizimi në Kosovë 1918-1941” (1980). Botoi edhe disa punime shkencore me këtë tematikë. Nga viti 1981 M. Obradović punoi si ligjërues në Fakultetin Filozofik të Prishtinës. (Haki Kasumi)

OBSERVATORI PARAHISTORIK I KOKINOS. Lokalitet arkeo-astronomik dardan. Shërbeu në parahistori si vend i shenjtë, në të cilin janë bërë qiellvrotimet dhe ritualet e kultit. Gjendet te kodra Kokino, 38 km në lindje të Kumanovës (Maqedoni). Si observator megalitik parahistorik është renditur i katërta në botë (NASA, 2005). U shfrytëzua për vrojtimin e lëvizjeve të diellit dhe të hënës që nga mijëvjeçari II p.e.r. Gjendet në majë të kodrës neovullkanike (1013 m), me rreth 90 m gjatësi dhe 50 m gjerësi dhe shtrihet në dy nivele. Mbi gjithë hapësirën mbisundojnë fronet e skalitura në shkëmb, të drejtuara kah lindja. Në të është konstatuar shënjuesi qendror guror dhe ato ndihmëse, që kanë shënjuar pikat e lëvizjeve të diellit dhe të hënës në horizontin e lindjes (solstici veror-dimëror, ekuinoksi vjeshtor-pranveror). Përmes tyre është përcaktuar koha e të korrave dhe e datave të tjera të rëndësishme për jetën e njeriut. Gjatë gërmimeve arkeologjike (2001) është zbuluar shtresa e epokës së bronzit, përfshirë fragmentet e qeramikës, me ornamente të diellit

me rreze. Observatori megalitik dëshmon se në epokën e bronzit janë zhvilluar qiellvrotimet e organizuara dhe dijet kozmologjike, andaj dhe labirinti unik rrethor i qarkut të mbyllur i Smirës mund të shihet si rezultat tejet i avancuar i dijeve të fituara dardane. (Edi Shukriu)

ODA E BURRAVE. Hapësirë ndeje dhe banimi, i ngritur në institucion të rëndësishëm sociokulturor dhe të trashëgimisë popullore në Kosovë. Në të kaluarën burrat dhe gratë kanë përdorur hapësira të ndara të qëndrimit ditor. Oda është shfrytëzuar nga burrat dhe djemtë e rinj, ndërsa shtëpia e zjarrit (shpia e zjermit ose shpia e robve) ka qenë dhoma ku gratë dhe fëmijët e kanë shfrytëzuar për ndejë dhe për përgatitje të ushqimit. Odës, zakonisht, i ka paraprirë edhe një odë e vogël ose divanhane. Meqenëse oda ka qenë e dedikuar për burra dhe miq, në raste të tilla renditja e tyre bëhej në bazë të rëndësisë që ka pasur miku apo miqtë, sipas prejardhjes familjare me premisa fisnore si dhe në bazë të statusit social të tyre, përveç prijësve fetarë që e kanë pasur vendin e paracaktuar në ballë të oxhakut, afër zotit të shtëpisë. Hapësira e brendshme e odës ka qenë e strukturuar në atë formë që ka përcaktuar statusin social, moshën dhe hierarkinë. Miqtë janë ulur zakonisht në anën e djathtë, në ballë të oxhakut, ku pranë tyre ka qëndruar edhe i zoti i shtëpisë, me emrin e të cilit, marrë në përgjithësi, është identifikuar edhe familja në tërësi. Të drejtat dhe obligimet e anëtarëve të familjes, si brenda ashtu edhe jashtë shtëpisë, kanë qenë përgjegjësi e të zotit të shtëpisë. Odat kanë zënë katet e sipërme të shtëpive apo kullave. Hyrja për në odë ka qenë nga dy anë, njëra nga ana e brendshme (nga oborri) për familjarët dhe të afërmit, ndërsa tjetra nga jashtë dhe ka shërbyer për vizitorë (miqtë). Ndër të tjera, oda e burrave ka luajtur rol të rëndësishëm edhe në aspektin edukativ, social dhe politik. Në odë janë mbajtur takime dhe kuvende të rëndësishme, që u kanë paraprirë ngjarjeve të mëdha historike, si kryengritjeve, pajtimit të gjaqeve në fillim etj. Sot, në shumicën e rasteve, odat shfrytëzohen vetëm për ndonjë ceremoni të veçantë, meqë në jetën e përditshme burrat dhe gratë shfrytëzojnë të njëjtën hapësirë për ndejë. (Tahir Latifi)

ODA EKONOMIKE E KOSOVËS (OEK). Asociacioni më i madh që përfaqëson interesat

e komunitetit të biznesit në Kosovë. U themelua në vitin 1962 nga Kuvendi i Kosovës dhe vepron si organizatë jofitimprurëse, e pavarur dhe profesionale. Përqendrohet në promovimin e investimeve, ndërmarrësinë dhe rritjen e aftësive konkurruese të anëtarëve të saj. Gëzon identitetin e një institucioni modern, i cili me profesionalizëm dhe vendosmëri kontribuon në zhvillimin e ndërmarrjeve, si dhe në përafrimin e biznesit kosovar me vlerat e ekonomisë europiane. OEK-u është burim i besueshëm i informatave për ndërmarrjet kosovare si dhe për ndërlydhjen me partnerë ndërkombëtarë. Për anëtarët e saj OEK-u ofron shërbime informuese, rrjetëzuese, lobuese, trajnuese, promovuese dhe këshillëdhënëse, me qëllim të përparimit të veprimtarive të tyre ekonomike. Është institucion i autorizuar për lëshimin e barkodeve për produkte kosovare, të certifikatave mbi origjinën e mallit, si dhe për ofrimin e shërbimeve të arbitrazhit. Të gjitha ndërmarrjet e anëtarësuar në OEK organizohen në shoqata specifike, sipas degëve dhe nëndegëve. Ka mbi 15,000 anëtarë të regjistruar dhe 30 shoqata sektoriale, të cilat funksionojnë si formë profesionale e organizimit dhe punës në kuadër të Odës. OEK-u ka zyrën qendrore në Prishtinë dhe zyrat regionale në Gjilan, në Ferizaj, në Prizren, në Gjakovë, në Pejë dhe në Mitrovicë (Fisnik Reçica)

ODALLOVIQ Moshò (Odalović Mošo) (1947-). Poet i letërsisë serbe nga Kosova, gazetar. Lindi në Grackë të Vjetër, afër Lipjanit. Mbaroi shkollën fillore në Lipjan, gjimnazin në Mitrovicë. Ishte gazetar dhe redaktor i faqeve për fëmijë të gazetës “Jedinstvo” në Prishtinë. Botoi libra me poezi për fëmijë dhe për të rritur: “Kështu e kaq” (1973), “Të të them diçka” (1977), “Gjenerali pikalosh” (1981), “Dikush e vodhi dallëndyshen” (1987), “Nëna është folje nga folja punoj” (1986), “Këtu diçka sështë në rregull” (1988), “Era m’i mori pantallonat” (1991), “Tom Sojeri në Mal të Zi” (1991), “Gjyshja është këtu, unë jam në Japoni” (1996), “Më pat thënë një fëmijë” (1997), “Ku është fëmija i llambës” (2008) etj. Botoi edhe disa romane për fëmijë. (Ismet Markoviq)

OHRI Hamdi (1872-1938). Veprimtar i lëvizjes kombëtare shqiptare. Lindi në Ohër, ku kreu edhe shkollën fillore. Arsimin e vazhdoi në Medresenë e Manastirit, më pas vijoi shkollën

ushtarake në Stamboll. Për shkak të aktivitetit të tij patriotik, u arrestua dhe u detyrua t’i ndërpriste studimet. Në vitin 1892 kthehet në Ohër, për të vazhduar më pas në qendra të ndryshme të Europës (Vjenë, Beograd dhe Bukuresht), prej nga shkoi në Stamboll, ku u arrestua sërish. Më pas u kthye në vendlindje dhe vazhdoi veprimtarinë e tij patriotike e kulturore-arsimore në Ohër, Strugë, Dibër, Rekë, Kërçovë etj. Ishte themeluesi i shkollës shqipe në Ohër (1897). U mor edhe me hartimin e një fjalori të gjuhës shqipe. Veprimtarinë patriotike e zhvilloi nëpër kolonitë shqiptare në Bukuresht, Sofje, Selanik e Stamboll. Vdiq dhe u varros në Tiranë. (Fadbi Osmani)

OKARINA. Instrument neolitik frymor muzikor. U zbulua në Runik të Skënderajt (Kosovë), duke zënë vend të veçantë si artefakt unik edhe për rajonin e më gjerë, në mesin e objekteve të vendbanimit më të hershëm neolitik të Kosovës. U punua nga argjila e pastruar mirë dhe e pjekur në lartësi prej 8 cm dhe ka vrimë paksa më të gjerë në aksin më të lartë/pipëza dhe dy boshtvrima për gishtërinj. Tingujt dhe vibrimet e ngrohta të instrumentit transmetojnë botën e pasur shpirtërore e muzikore të njeriut neolitik të Kosovës. U krijua në neolitin e hershëm (kultura e Starçevës), që mund të njihet edhe si kultura e Runikut (mijëvjeçari VII-VI p.e.r.). (Milot Berisha)

OLBRAJT Medlin (Madeleine Albright) (1937-). Sekretare e Shtetit e SHBA-së në periudhën 1997-2001. Lindi në Smichov të distriktit të Pragës në Çekosllovakia, me emrin Marie



MEDLIN OLBRAJT

Jana Korbelová. Vitet e para të jetës i kaloi në Beograd, pasi babai i saj ishte diplomat i Çekosllovakisë në Jugosllavi. Gjatë Luftës së Dytë Botërore jetoi në Britani. Pas Luftës kthehet në Pragë. Babai i saj emërohet ambasador në Beograd, ndërsa ajo u shkollua në Zvicër. Më 1948 u vendos në SHBA. Më 1955 diplomoi në Kent Denver dhe vazhdoi studimet në Masashusets për shkencat politike, ku diplomoi më 1959. Më 1957 iu bashkua Partisë Demokratike. Presidenti Bill Clinton e angazhoi M. Olbrajt në Këshillin e Sigurimit Kombëtar.

Më pas emërohet ambasadore e SHBA-së në Kombet e Bashkuara. Më 23 janar të vitit 1997 emërohet Sekretare e Shtetit. U bë femra e parë Sekretare e Shtetit dhe gruaja e nivelit më të lartë në hierarkinë shtetërore amerikane. M. Olbrajt u angazhua drejtpërdrejt në çështjen e Kosovës. Pas masakrës së Reçakut, ajo paraqiti para liderëve europianë një plan për konferencën ndërkombëtare për Kosovën dhe fillimin e negociatave shqiptaro-serbe, me ndërmjetësimin e Grupit të Kontaktit. Më 29 janar 1999 në Londër, M. Olbrajt deklaroi mbajtjen e Konferencës në Rambuje të Francës. Me angazhimin dhe ndihmën e saj të drejtpërdrejtë, negociatat përfunduan më 18 mars 1999, ku delegacioni amerikan, britanik dhe kosovar e nënshkruan marrëveshjen, kurse e bojkotuan delegacioni rus dhe ai serb. Diplomacia amerikane e udhëhequr nga M. Olbrajt mbështeti ndërhyrjen ushtarake të NATO-s në Kosovë. Në vitin 2001 e përfundoi mandatin si Sekretare e Shtetit të SHBA-së. Pas luftës së vitit 1999, në Kosovë u emëruan me emrin e saj shumë rrugë, sheshe dhe institucione. (Naim Musliu)

OLLONI Ali (1947-2003). Gazetar, shkrimtar. Lindi në Gjakovë. Në vendlindje kreu shkollën fillore dhe të mesme. Studioi në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës. Nga viti 1971 punoi gazetar dhe redaktor i kulturës në revistën javore “Zëri i rinisë”. Më pas ishte redaktor i informacionit në Televizionin e Prishtinës. Gjatë viteve ‘80 ishte redaktor në gazetën ditore “Rilindja” dhe më vonë në gazetën “Bujku”. Mbas vitit 1999 punoi redaktor i rubrikës së kulturës në gazetën “Koha ditore” dhe, së fundi, pas vitit 2000 redaktor në agjencinë e lajmeve “Kosova live”. Krahas punës në gazetari, A. Olloni shkroi poezi, prozë poetike dhe ese. Botoi librat “Vjeshta në mars” (1972), “Gjarpëri në gisht” (1979), “Portreti i Lah Pusit” (1988), përmbledhjen e prozave poetike “Puhizë në pezhishkë” (1999), si dhe librat publicistikë “Gjurmë” dhe “Opinionë”. Më 1988 fitoi çmimin për gazetari nga Shoqata e Gazetarëve të Kosovës dhe më 1998 u shpall “Gazetar i vitit” nga gazeta “Rilindja”. (Ibrahim Berisha)

OLLURI Adil (1984-). Shkrimtar, studiues i letërsisë, kritik letrar. Lindi në Krojmir të Lipjanit. Kreu shkollimin fillor në vendlindje, ndërsa të mesmin në Shtime. Ndoqi studimet për gjuhë dhe letërsi në Fakultetin e Filologjisë

të Universitetit të Prishtinës. Shkruan prozë, kritikë letrare dhe shkrime të ndryshme për fenomene kulturore. Që nga viti 2010 është redaktor i revistës letrare “Jeta e re”. Disa vjet punoi në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, ndërsa më pas në Institutin Albanologjik të Prishtinës. Deri më tani ka botuar këto vepra: “Trilogjia postmoderne”, monografi (2011); “Romani postmodern shqiptar”, monografi (2011); “Shumë rrugë dhe një rënie”, tregime (2013). Libri i dytë studimor “Romani postmodern shqiptar” është shpërblyer me çmimin vjetor të Ministrisë së Kulturës, si vepra më e mirë në fushën e kritikës letrare, e botuar brenda vitit 2011. Tregimi i tij “Kthimi i babait”, që është pjesë e librit “Shumë rrugë dhe një rënie” është përkthyer në pesë gjuhë. (Agron Gashi)

OPERACIONET PËR ÇLIRIMIN E KOSOVËS (tetor-nëntor 1944). Operacione të zhvilluara në tetor dhe nëntor të vitit 1944 për sulm ofensiv mbi forcat gjermane të pushtimit, për çlirimin përfundimtar të Kosovës. Plani për këtë operacion u hartua nga udhëheqja e Lëvizjes Nacionalçlirimtare në Kosovës. Në luftimet për çlirimin e Kosovës morën pjesë njësitet e Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Shqipërisë (UNÇSH), të Armatës Bullgare si dhe të Ushtrisë Nacionalçlirimtare (UNÇ) dhe Aradheve Partizane Jugosllave (APJ). Planin përfundimtar për çlirimin e Kosovës nga forcat gjermane e ndërmori Shtabi Operativ i UNÇ-së dhe APJ-së për Kosovë dhe Dukagjin, i cili komandohej nga Fadil Hoxha. Më 23 tetor u caktua fillimi i operacionit për çlirimin e Prishtinës, për çka do të vihej në veprim nga Divizioni i 46-të serb dhe Divizioni i dytë bullgar i kavalerisë, të cilët, pasi të kalonin Bujanocin, planifikonin të hynin nëpërmjet Gjilanit në drejtim të Prishtinës. Ndërkaq Brigada e parë dhe e katërt e Kosovës si dhe Brigada e tretë dhe e pestë e UNÇSH-së u përqendruan në çlirimin e territorit të Dukagjinit, ku vepronte grupi luftarak gjerman “Skënderbeu”. Këto njësite luftuan në rrugët Prizren-Shkodër dhe Prizren-Deçan, ndërkaq aradhet partizane luftuan me vullnetarët shqiptarë në fshatra të Gjakovës. Brigada e parë e Kosovës dhe Brigada e tretë e Shqipërisë vepronin në drejtim të Deçanit dhe Pejës, ndërkaq Brigada e katërt e Kosovës dhe Brigada e pestë e Shqipërisë vepronin në drejtim të Dragashit, Gjakovës,

Prizrenit dhe Pejës, nga të cilat së pari e çliruan Dragashin më 5 tetor. Pas një muaj luftimesh, Brigada e katërt e Kosovës dhe Brigada e pestë e Shqipërisë çliruan Gjakovën më 9 nëntor 1944 e pastaj Prizrenin, Pejën dhe Istogun më 17 nëntor. Këto luftime penguan depërtimin e grupit luftarak "Skënderbeu" në drejtim të Malit të Zi, gjë që i shtyu ato të tërhiqeshin në drejtim të Mitrovicës.

Ndërkohë në muajin e tetorit u zhvilluan luftime në Rrafshin e Kosovës ndërmjet Divizionit 24 dhe 46 bullgar, Divizionit 22 serb si dhe Brigadës së dytë, tretë dhe të pestë të Kosovës kundër forcave në tërheqje të armatës gjermane "E". Divizioni i dytë bullgar i kavalerisë dhe Brigada e 25 e Divizionit 46 serb çliruan Gjilanin më 16 nëntor, ndërsa më 17 nëntor në Ferizaj hyri Brigada e dytë e Kosovës. Më 19 nëntor trupat bullgare dhe serbe hynë në Prishtinën e braktisur nga gjermanët. Brigada e tetë serbe hyri më 20 nëntor në Vushtrri, e cila gjithashtu ishte e braktisur dhe më 22 nëntor Brigada tankiste bullgare dhe Brigada e 12-të serbe hynë në Mitrovicë. Më 23 nëntor Brigada e 10-të e Divizionit 22 serb hyri në "Trepçë." Në fund të nëntorit 1944 i tërë territori i Kosovës u konsiderua i çliruar nga forcat gjermane, ndërsa më pastaj luftimet vazhduan ndërmjet forcave nacionaliste shqiptare dhe atyre partizane. (Mrika Limani)

OPERACIONI "REKA" (27-28 prill 1999). Operacion i përbashkët i ushtrisë dhe i policisë serbe, i zhvilluar më 27 dhe 28 prill të vitit 1999 në fshatrat në perëndim të Gjakovës. Ushtarët dhe policët serbë, në mënyrë të koordinuar, duke filluar nga pjesa veriore e luginës Reka dhe duke lëvizur në drejtim të jugut, hynë në fshatrat e banuara nga shqiptarë (Dobrosh, Ramoc, Racaj, Korenicë, Molliq, Brovinë, Guskë, Nivokaz dhe të tjera) dhe urdhëruan popullsinë t'i braktiste shtëpitë dhe të largoheshin në drejtim të Shqipërisë. Gjatë debimit të civilëve nga shtëpitë e tyre, pjesëtarët e forcave serbe vranë shumë civilë. Vetëm në fshatin Korenicë u vranë 68 sish. Me mijëra banorë të zonës, të dëbuar nga fshatrat, formuan dy kolona të gjata me mjete transporti, që lëviznin në drejtim të qytetit të Gjakovës. Kolonat u ndalën nga policia serbe në fshatin Mejë, ku burrat u ndanë nga gratë dhe fëmijët dhe më pas u pushkatuan në lokacione të ndryshme. Me atë rast u vranë 274

veta, në mesin e të cilëve ishin edhe 36 djem të moshës jomadhore. Mbetjet mortore të 252 prej tyre janë gjetur në vitin 2001 në varrezën masive në Batajnicë, afër Beogradit. Gjatë këtij operacioni, pjesëtarët e forcave serbe kanë vranë së paku 350 civilë, kurse mijëra të tjerë u deportuan në Shqipëri. Sulmi i forcave serbe ndaj popullatës civile në luginën e Rekës, sipas numrit të viktimave, është krimi më i rëndë i kryer ndaj civilëve gjatë luftës në Kosovë dhe njëri nga më të mëdhenjtë në luftërat në ish-Jugosllavi. (Valdrin Ukshini)


OPERACIONI "SHIGJETA" (26 maj 1999). Operacion i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) me qëllim të thyerjes së mbrojtjes së ushtrisë serbe në kufi me Shqipërinë dhe depërtimit të forcave sulmuese sa më në thellësi të territorit të Kosovës. Hartimi i planit për këtë operacion u bë në Jezerc (Ferizaj), ku ndodhej pjesa kryesore e Shtabi të Përgjithshëm të UÇK-së dhe e Qeverisë së Përkohshme të Kosovës. Plani, që përfundoi së hartuari më 17 prill 1999, ishte përgjigje për rrethanat e reja të krijuara me intensifikimin e sulmeve të NATO-s brenda territorit të Kosovës dhe shtimin e formacioneve të UÇK-së në 20 mijë luftëtarë, gjë që mundësonte zhvillimin e luftimeve në nivelin taktik-operativ. Pas kërkesës së Qeverisë së Përkohshme të Kosovës dhe Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së për mobilizim të përgjithshëm më 2 prill 1999, në Shqipëri kishin arritur edhe 12 mijë vullnetarë. Në atë plan luftarak u përfshinë edhe veprimet luftarake të zhvilluara nga forcat që patën sulmuar prej 8 prillit në Koshare, të emërtuara nga Brigada 138 "Agim Ramadani", e që më vonë kaluan në varësi të Zonës së Tretë Operative të Dukagjinit. Ideja e Operacionit "Shigjeta" ishte thyerja e mbrojtjes së ushtrisë serbe në kufirin me Shqipërinë dhe depërtimi sa më i shpejtë i forcave sulmuese të UÇK-së në thellësi të territorit të Kosovës, në drejtimin më të shkurtër: Qafa e Prushit-Rahovec; pastaj vendosja e kontaktit me forcat e Zonës së Dytë Operative të Pashtrikut, në vijën përgjatë rrugës Prizren-Gjakovë; si dhe krijimi dhe mbajtja hapur e korridorit të përhershëm të furnizimit me Shqipërinë në drejtimin Qafa e Morinës-Dukagjin. Goditja kryesore kundër forcave serbe u parashikua dhe u dha në drejtimin maja e malit Pashtrik-Krushë, si dhe në drejtimet ndihmëse Qafa e Prushit-

Rahovec dhe Gorozhup-Krushë. Forcat kryesore pjesëmarrëse në këtë operacion hyn në luftime më 26 maj 1999, duke filluar sulm të njëkohshëm në të tri drejtimet e planifikuara. Në atë operacion u angazhuan 8,000 forca. (Dilaver Goxhaj)

OPERATORËT E RRJETIT PUBLIK TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE. Organizatë ose kompani që ka të drejtë të ndërtojë, të posedojë, të japë me qira dhe të shfrytëzojë një rrjet publik të komunikimeve elektronike dhe objektet e pajisjet shoqëruese përkatëse, si dhe të ofrojë shërbime të komunikimeve elektronike (në formë të shenjave, shkrimit, zërit, imazheve apo të të dhënave). Operatorët kryesorë të rrjeteve publike të komunikimeve elektronike në Kosovë, të licencuar nga Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP) janë: Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës sh. a. (PTK) dhe IPKO për shërbime të telefonisë fikse, PTK dhe IPKO për shërbime të telefonisë mobile, PTK, IPKO dhe “Kujtesa” për shërbime të internetit. Në mungesë të kodit telefonik shtetëror për Kosovën, për shumë vite kanë qenë në përdorim tre prefikse: prefiksi +381, që shfrytëzohet për shërbime të telefonisë fikse nga “Telekomi” i Kosovës (njësi biznesi e PTK-së) dhe nga IPKO dhe prefikset +377 dhe +386, që shfrytëzohen për shërbime të telefonisë mobile, i pari nga “Vala” (njësi biznesi e PTK-së), ndërsa i dyti nga IPKO. Ndërkohë, Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacioneve (ITU) i ndau Kosovës prefiksin +383, i cili u vu në funksion nga mesi i vitit 2017. Ndërkaq, në tremujorin e parë të vitit 2015 në Kosovë kishte 62,384 përdorues të telefonisë fikse, 1,676,287 përdorues të telefonisë mobile 193,550 përdorues të internetit me qasje fikse dhe 358,184 përdorues të internetit me qasje mobile. Norma e penetrimit (numri i telefonave për banor) të telefonisë fikse në Kosovë (3.44%) vazhdon të jetë shumë e ulët krahasuar me vendet e rajonit (rreth 10%), e sidomos me shtetet e BE-së (rreth 40%). Penetrimi i telefonisë mobile në këtë periudhë ishte 92.33%. Penetrimi i shërbimeve të internetit përmes qasjes fikse ishte 10.66 % për banor dhe 65.15% për shtëpi; ndërsa penetrimi i shërbimeve të internetit përmes qasjes mobile ishte 19.74%. PTK-ja ka pothuajse statusin e monopolistit në telefoninë fikse: PTK 97,63%,

IPKO 2, 33%. Ndarja e tregut të telefonisë mobile sipas përdoruesve për operator ishte: “Vala” 53.0%, IPKO 36.5%, “Z-mobile” (operator virtual, i cili e përdor rrjetin e operatorit “Vala” dhe prefiksin e Monakos: +377) 10.5%. Ndarja e tregut të internetit sipas përdoruesve për operator ishte: IPKO 47.1%, “Kujtesa” 24.0%, PTK 17.7%, të tjerët 11.2%. (Nebi Caka).

OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMISIONIT TË ENERGJISË (KOSTT). Kompani në pronësi publike, përgjegjëse për operim, planifikim, mirëmbajtje dhe zhvillim të rrjetit



NJË LARGPËRÇUES, PJESË E SISTEMIT TË TRANSMISIONIT TË ENERGJISË NË KOSOVË

të transmissioinit të sistemeve elektroenergjetike (SEE) të Kosovës dhe të linjave ndërlidhëse ndërmjet SEE-së dhe shteteve fqinje, për të siguruar furnizim të qëndrueshëm me energji për konsumatorët. KOSTT-i është gjithashtu përgjegjës për funksionim dhe operim të tregut të energjisë elektrike me shumicë në Kosovë. U themelua gjatë procesit të ristrukturimit të sektorit të energjisë elektrike (2006), në pajtim me dispozitat e Ligjit për energjinë elektrike dhe me kushtet e Traktatit të Komunitetit të Energjisë në Europën Juglindore (KEEJL). KOSTT-i është operator i vetëm i sistemit dhe i tregut në Kosovë dhe operon në bazë të licencave të lëshuara nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë Elektrike (ZRRE) dhe obligimeve që dalin nga ligjet dhe rregulloret e sektorit të energjisë në Kosovë. KOSTT-i menaxhon

sistemin e transmisionit, duke operuar me linjat dhe nënstacionet e tensionit të lartë (400 kV, 220 kV, 110 kV) dhe të mesëm (35 kV, 10 (20) kV). Gjatësia e linjave të tensionit të lartë është 1,197 km, me kapacitet të bartjes prej 1,550 MW, ndërsa kapaciteti i transformues i 36 nënstacioneve është 4,880 MVA. SEE-ja i Kosovës, i ndërlidhur me SEE-të e shteteve fqinje, paraqet një nyjë të rëndësishme të transmisionit në Europën Juglindore. KOSTT-i ka investuar shumë për ta ngritur infrastrukturën teknike, ligjore e rregulluese, për t'u inkuadruar në mekanizmat përkatës rajonalë dhe europianë. KOSTT-i ka nënshkruar marrëveshjen për operim me të gjithë operatorët e sistemeve të shteteve fqinje. KOSTT-i vazhdon aktivitetin lidhur me liberalizimin e tregut të energjisë elektrike në Kosovë dhe në rajon, në përputhje me objektivat dhe kërkesat e Qeverisë së Kosovës rreth liberalizimit të tregut, të bazuara në legjislacioni primar të sektorit të energjisë, të Traktatit të KEEJL-it dhe të direktivave të Komisionit European. (Justina Shiroka-Pula)

OPOJA. Trevë etnogeografike kodrinore-malore në jug të Kosovës, në kuadër të komunës së Dragashit (Sharrit). Kufijtë janë të përcaktuar përmes relievit dhe hidrografisë. Opoja



OPOJA

shtrihet në pellgun e lumit të Plavës, ndrmjet malit Koritnik në perëndim, të Sredskës në lindje, të Gorës në jug dhe rajonit të Vërrinit në veri. Sipërfaqja e Opojës është rreth 126 km² dhe ka shtrirje verilindje-jugperëndim. Pjesa më e madhe e Opojës ndërtohet nga shkëmbinj të vjetër të moshës paleozoike (gneise, filite, rreshpe etj.), mesozoike (gëlqerorë) dhe kuaternarit (sedimentet liqenore, glaciale, pro-

luvione, deluvione, aluvione). Shtrihet në mes 700-2,493 m lartësi mbidetare, me lartësi mesatare 1,368 m. Relievi pjerrësohet në drejtim të lumit të Plavës. Dallohen forma të relievit karstik në Zgatar (shpella, humnera, hurdhja etj.). Karakterizohet me dimra relativisht të ftohtë dhe vera jo shumë të nxehta (gushti me 18°C), mesatarja vjetore e temperaturës rreth 8.3°C, reshjet mesatare rreth 1,000 mm. Paraqiten burime të vogla të ujërave nëntokësore. Rjedha kryesore ujore është lumi i Plavës. Në Opojë ndodhet liqeni i Breznës (liqen relik). Janë të përhapura tokat aluviale-deluviale, të kuqërremta dhe pak të përhimëta. Bimësia përfaqësohet nga pyjet e ahut, të pishave dhe kullotat alpine.

Opoja ka gjithsej 19 vendbanime, të gjithë të banuara me shqiptarë. Me regjistrimin e vitit 1948 jetonin 8,875 banorë, kurse në 1991 u vlerësuan se jetojnë rreth 22,081 banorë. Me regjistrimin e vitit 2011, të pranishëm ishin 19,262 banorë. Një pjesë e popullsisë jeton në migrim. Popullsia merret kryesisht me blegtori dhe pylltari. Vendbanimet më të mëdha janë Bresana (2,839 banorë) dhe Brezna (1,990 banorë). (Valbon Bytyçi)

OPOJA Reshad (1922-). Mjek, pediatër, primarius. Lindi në Prizren, arsimin fillor e kreu në Prizren dhe më pas mbaroi Medresenë “Gazi Mehmet Pasha” po në Prizren. Gjatë viteve 1936-1941 kreu edhe 5 klasë të Medresesë së Madhe në Shkup dhe më pas edhe tri klasë në gjimnazin “Sami Frashëri” në Prishtinë (1944). U diplomua në Fakultetin e Mjekësisë në Universitetin e Sarajevës (1953). Pas përfundimit të studimeve, u kthye në vendlindje. Specializoi për pediatri në Fakultetin e Mjekësisë në Beograd. Pas specializimit punoi në shërbimin pediatrik të Qendrës Mjekësore në Prizren. Në vitin 1973 mori titullin primarius. Mori shumë mirënjohje dhe dekorata. Publikoi shumë punime profesionale dhe shkencore. (Sejduallah Hoxha)

ORA Rita (Sahatçiu) (1990-). Këngëtare dhe aktore. Lindi në Prishtinë. Më 1991 prindërit e saj u shpërngulën në Londër. Atje kreu shkollimin e ulët, të mesëm e të lartë. Filloi të këndojë qysh si fëmijë. Më 2008 u kualifikua për Garën e “Eurovizionit” të Britanisë, por u tërhoq për shkaqe karriere. Më 2012 kënga “Hot Right Now”, bashkë me Dj Fresh, ishte e para



RITA ORA

në listën britanike “UK Singles Chart”. Asokohe filloi punën për albumin e parë dhe kënga “R.I.P” doli në vendin e parë të kësaj liste. Kënga tjetër “How we Do” po ashtu doli e para në listën britanike dhe irlandeze. Më 2012 botoi albumin “Ora” që debutoi në listën “UK Album Chart”. Në fund të atij viti, me përkrahjen e MTV-së bëri turneun “Ora Tour” në SHBA. Më pas realizoi këngën “Shine Ya Light” që arriti në 10 më të mirat e listës “UK Singles Chart” (videoja u realizua në Prishtinë). Më 2013 bëri një turne në Britani në përkrahje të albumit “Ora”. Më 2014 realizoi këngën “I Will Never Let you Down” që gjithashtu arriti vendin e parë në “UK Singles Chart”. Me këngën e Iggy Azalea-s “Black Window” arriti vendin IV në Britani dhe vendin III në listën “ Billboard Hot 100”. Më 2015 realizoi këngën “Poison”, e cila u ngjit në vendin III në listën “UK Singles Chart”. Ka aktruar në disa filma. Paraqitjen e parë si 13-vjeçare e kishte në serinë e dramave “The Brief”, më pas luajti në filmin “Spivs” (2004) rolin e një emigranteje shqiptare. Ka luajtur në filmat “Fast & Furious 6” (2013), “Fifty Shades of Gray” (2015), “Southpaw” (2015). Është fituese në një sërë festivalesh, si “MOBO Awards” (2012), “Urban Music Awards” (2012), “Glamour Women of the Year Awards” (2013), “Glamour Awards” (2015). Mori pjesë në spektakle me karakter bamirësie. Më 2015 u emërua Ambasadore Nderi nga presidentja e Kosovës. Jeton e vepron në Londër. (Xhevdet Gashi)

ORANA Halim (1914-1947). Veprimtar i Lëvizjes Nacional Demokratike Shqiptare (LNDSH). Lindi në Gjilan, ku kreu shkollën fillore, kurse shkollën e mesme e regjistori në Banja Llukë të Bosnjës dhe Hercegovinës, ndërsa më vonë vazhdoi në Shkup shkollën normale, të cilën e përfundoi më 1932. Punoi si mësues në disa fshatra, ndërsa nga viti 1936 deri më 1941 jetoi në Velika Klladushë të Bosnjës, ku gjithashtu punoi si mësues. Pas vitit 1941 vendoset në Zagreb, ndërsa pas kapitullimit të Italisë (shtator 1943), qeveria shqiptare e Tiranës e emëroi përfaqësues të Shqipërisë në shtetin e pavarur kroat me seli

në Zagreb. Me hyrjen e forcave partizane në Zagreb, arrestohet, por lirohet në mungesë të provave. Arrestohet për herë të dytë në Beograd, më 1946, prej nga e sjellin në Ferizaj, por prapë lirohet për mungesë provash për veprimtari antishtetërore. Po atë vit vendoset në Shkup dhe përfshihet në radhët e LNDSH-së. Merr pjesë në Kongresin IV të LNDSH-së, i cili u mbajt më 1 qershor 1946 në Shkup. Në këtë Kongres H. Orana u zgjodh kryetar i Komitetit Qendror të LNDSH. Pas disa muajsh aktiviteti, organet shtetërore jugosllave zbulojnë veprimtarinë e Komitetit dhe i burgosin anëtarët e tij. Burgoset në Zagreb më 10 shkurt 1947 dhe dërgohet në burgun ushtarak të Beogradit. Disa muaj më vonë, në shtator të atij viti dënohet me vdekje nga Gjykata Ushtarake e Beogradit, nën akuzën për veprimtari në Lëvizjen Nacional-Demokratike Shqiptare dhe si udhëheqës i saj. Ekzekutimi i tij u bë në fshehtësi. (Naim Musliu)


ORANA Nexhat (1930-1996). Inxhinier i elektroteknikës, profesor universiteti. Lindi në Gjilan, ku kreu shkollën fillore, kurse gjimnazin e kreu në Prishtinë. Studimet për inxhinieri elektrike, drejtimi i telekomunikacionit dhe elektronikës, i kreu në Fakultetin Elektroteknik (FE) të Universitetit të Beogradit (1957), ndërsa një vit më vonë mbaron studimet në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore, në grupin e matematikës, po në Beograd. Disertacionin e mbrojti në Fakultetin Teknik të Universitetit të Prishtinës (UP). Pas studimeve një kohë punoi në Radio-Shkupi si inxhinier për televizion. Me hapjen e Shkollës së Lartë Pedagogjike në Prishtinë (1959), ligjëroi në lëndët gjeometri elementare dhe gjeometri deskriptive. Më 1961 u zgjodh ligjërues në Shkollën e Lartë Teknike në Prishtinë dhe më 1986 profesor i rregullt në FE të UP-së për lëndët bazat e elektroteknikës dhe teoria e përhapjes së valëve dhe antenat. Punoi dhe si inxhinier për radio dhe televizionin në Radio-Prishtinë, ku dha kontribut të veçantë në ndërtimin e repetitorit për TV në Veternik dhe të punktimit në Golesh, si dhe për sigurimin e brezit të frekuencave për Kosovën. Ishte shef i Qendrës Elektronike



NEXHAT ORANA

Llogaritëse të Fakultetit Teknik dhe dekan i këtij fakulteti. Është autor i dy teksteve universitare ("Bazat e elektroteknikës" I dhe II) dhe autor e bashkautor i shumë punimeve të botuara në revista shkencore vendore dhe ndërkombëtare. (Ali Gashi).

ORANA Xhelal (1928-2006). Gjeolog, mësimdhënës universitar. Lindi në Gjiçan, ku kreu shkollën fillore, ndërsa shkollën e mesëm në Prishtinë. Në vitin 1955 u diplomua në Fakultetin Mineral-Gjeologjik në Beograd.



XHELAL ORANA

Në fillim të karrierës punoi në Gjiçan si referent për kërkime gjeologjike dhe eksploatimin e lëndës minerale. Në vitin 1959 u zhvendos në Shkup, si shef i seksionit për konsolidim të truallit në ndërmarrjen "Makrofill". Në vitin 1969 u zgjodh ligjërues në Fakultetin Teknik të Universitetit të Prishtinës dhe më vonë ligjërues në studimet pasuniversitare në Fakultetin e Ndërtimitarisë dhe të Arkitekturës të UP-së. Ushtrroi detyra të ndryshme udhëheqëse në Fakultetin Teknik, ndërsa ishte i përfshirë në një sërë komisionesh dhe komitetesh, si kryetar i Komisionit të Sekretariatit të Krahinor për Ekonomi dhe për verifikim të rezervave të lëndës minerale, anëtar i Kryesisë së Komitetit të ish-Jugosllavisë për Hidrogeologji dhe Gjeologji Inxhinierike etj. Mori pjesë në ndërtimin e shumë digave në Kosovë dhe Maqedoni. Është autor i disa punimeve shkencore nga lëmi i gjeologjisë inxhinierike, minerale dhe ndërtimore. (Fetah Jagxhiu).

ORBINI Mauro (shek. XVI-1611/1614). Shkrimtar, kronist, historian raguzan dhe abat benediktin i njohur me veprën "Mbi mbretërinë sllave" ("Il Regno de gli Slavi"), të botuar në vitin 1601, e cila influencoi ideologjinë pansllave dhe historiografinë e sllavëve të jugut në shekujt e mëvonshëm. Lindi në Raguzë (Dubrovnik), ndarsa me origjinë ishte nga Gjiri i Kotorrit. Në shërbim të Republikës së Raguzës kishte qendër në oborrin papnor në Romë (1606), më pas jetoi si murg në Mlet, në Ston, në Hungari dhe së fundi në Raguzë. Është i njohur si njëri ndër pansllavistët e parë kroatë. Në vitin 1680 veprën e tij ia kishte prezantuar historiografinë europiane bizantologu Ch. Du Cange. Kjo

histori jokritike e sllavëve, e përkthyer edhe në rusisht më 1722 do të ushtrrojë ndikim të rëndësishëm mbi idetë e popujve sllavë rreth vetes dhe mbi idetë europiane për sllavët.

Për hartimin e veprës "Mbi mbretërinë e sllavëve", Orbini shfrytëzoi tekste të autorëve të kohës, si: Bonfini, Sabellico, Barleci, Beçikemi, Pikolomini, Segoni, Cervari-Tuberonin etj. Autori ofron njoftime të shumta për historinë e periudhës së Humanizmit dhe të Rilindjes, për ilirët dhe Ilirinë, për kolonitë romake të qyteteve të Dioklesë dhe gjuhën ilire të folur këtu; për qytetet e Kosovës gjatë mesjetës: Prishtinën, Prizrenin, Novobërdën, Trepçën; pastaj për Betejën e Kosovës më 1389; për Balshajt, Skënderbeun; pasazhe për Milosh Kobiliqin, fjalimin e Lazarit para Betejës së Kosovës, tradhtinë e Vuk Brankoviqit; për emrin Kosovë; për kryqëzatën e vitit 1444 në Varna; për Betejën e Dytë të Kosovës më 1448; për ekspeditën e Janosh Huniadit në Kosovë më 1448 etj. (Gjon Berisha)

ORDO DECURIONUM. Këshill i qytetit i periudhës romake. Përbënte këshillin e një qyteti romak, i kompozuar sipas imazhit të senatit romak dhe njihej edhe si splendidus ordo dhe splendidissimus ordo. Numri i anëtarëve ishte dhjetë, por ky numër luhatej nga qyteti në qytet, në varësi të dinamikës ekonomike dhe dimensionit demografik të qyteteve. Administronte territorin e qytetit, ishte përgjegjës për sigurinë, financat, rritja fetare, argëtuese etj. Anëtarët e tij zgjidheshin nga shtresa "curialis" dhe kishin mandat të përjetshëm. Është dëshmuar se këshillin e dekurionëve në territorin e Dardanisë e kishin qytetet, si: Scupi, Ulpiana, Naissus, Municipium DD, Municipium te Dërsniku etj. Dekurionë në Alba Julia të provincës së Dakisë ishin dhe dedikuesit e monumentit kushtuar Hyjneshës Dardane të zbuluar në Rumani. (Arben Hajdari)

OREL Vladimir (1952-2007). Gjuhëtar rus. Studioi për gjuhësi teorike (1971) dhe gjuhësi strukturale (1973) në Universitetin e Moskës. Doktoratën e mbrojti më 1981 me temën "Struktura dhe karakteristikat e gjuhëve sllave të Ballkanit". Ishte student i Desnickajas. Deri më 1990 punoi në Institutin e Studimeve Sllave dhe Ballkanike në Moskë, ku më 1989 përfundoi tezën e dytë të doktoratës "Krahasimi



VLADIMIR OREL

historik i gramatikës së gjuhës shqipe: fonetika dhe morfologjia". Pas emigrimit në Izrael, dha mësim Universitetin e Jerusalemit (1991-1992) dhe në Universitetin e Tel Avivit. Botoi artikuj, studime dhe recensione të shumta, monografi, ndër

të cilat: "Fjalor etimologjik i familjes së gjuhëve hamito-semitike" (1995, së bashku me Olga Stolbova-n), "Gjuha frigase" (1998), "Fjalor etimologjik i shqipes" (1998), "Gramatikë e përmbledhur historike e shqipes" (2000), "Manual i etimologjisë së gjermanishtes" (2003), "Fjalor etimologjik i rusishtes I-III" (2007, 2007, 2008). "Fjalori etimologjik i shqipes" (1998) është pasqyrë e dobishme për etimologjitë ekzistuese, që bazohet në veprat e paraardhësve G. Majer, E. Çabej dhe në studimet e dijetarëve N. Jokl, M. Fasmer, E. Hemp etj. Po kështu është autor i "Gramatikës historike të gjuhës shqipe" (2000). (Hana Radoniqi)

ORGANIZATA "KOSMET". Organizatë politike e studentëve të Kosovës, e themeluar në Beograd si kundërvënie ndaj organizatës nacionaliste shqiptare "Besa". Organizata në fillim përbëhej kryesisht nga studentët kolonistë malazias, të vendosur në Kosovë përmes të ashtuquajturës reformës agrare. Pas vitit 1937 organizatës iu bashkuan edhe shumë studentë shqiptarë nga Kosova dhe viset e tjera shqiptare, që studionin në Universitetin e Beogradit dhe në qytetet e tjera të Mbretërisë së Jugosllavisë. Organizata arriti t'i përfitonte shqiptarët, sepse doli haptas kundër grabitjes së pronave të popullsisë shqiptare. Më 1937 ajo doli publikisht me një proklamata, në të cilën kundërshtoi vendimin e Qeverisë Jugosllave për marrëveshjen e lidhur me Qeverinë Turke për shpërnguljen e shqiptarëve për në Turqi. Kjo proklamata e shkruar në gjuhën shqipe dhe serbe u shpërnda pothuaj në tërë Kosovën. (Ibir Zylfiu)

ORGANIZATA BOTËRORE E SHËNDE-TËSISË (OBSH). Është autoritet drejtues dhe bashkërendues për shëndetësi i Organizatës së Kombeve të Bashkuara. OBSH-ja ishte e pranishme në Kosovë që nga viti 1998. Gjatë periudhës së pasluftës (1999-2004) luajti

rolin kryesor dhe koordinues në përpjekjet e bashkësisë ndërkombëtare dhe autoriteteve të përkohshme vendore për rindërtimin e institucioneve shëndetësore të shkatërruara gjatë luftës dhe për rimëkëmbjen e sistemit shëndetësor kosovar. Ndihmoi në strukturimin e sistemit të ri shëndetësor, me konceptin e mjekësisë familjare si gurthemel i tij. Duke njohur si sfidën më të madhe vdekshmërinë dhe sëmurjen e grave në periudhën përreth lindjes, të porsalindurve dhe fëmijëve të moshës 0-5 vjeç, ndihmën më të madhe e ofroi në sferën e shëndetit të grave dhe fëmijëve. Përmirësimi i ndjeshëm në treguesit e shëndetit të këtyre kategorive i përshkruhet zbatimit të programeve dhe strategjive të OBSH-së në këtë fushë të kujdesit shëndetësor. Gjithashtu, një kontribut dhe angazhim të veçantë OBSH-ja ofroi edhe në sferën e përmirësimeve të vazhdueshme të cilësisë në shëndetësinë publike, shëndetin e adoleshentëve, shëndetin mjedisor, shëndetin mendor, sistemin e informimit shëndetësor, parandalimin, regjistrimin dhe menaxhimin e sëmundjeve ngjithëse dhe jongjitëse, si dhe në hartimin e politikave, programeve, strategjive dhe udhërrëfyesve kombëtarë përkatës. Gjatë këtyre viteve, me kalimin e fazës emergjente dhe përmirësimet e ndjeshme në indikatorë të shëndetësisë publike në Kosovë, edhe prania e OBSH-së u zvogëlua gradualisht, kështu që nga një personel prej mbi 200 vetash sa ishin të angazhuar në vitin 2000, pesëmbëdhjetë vjet më vonë zyra e OBSH-së funksionon në Kosovë me një staf prej vetëm 7 personash. (Skënder Sylja)

ORGANIZATA BOTËRORE E TREGTISË (OBT). Organizatë ndërkombëtare që krijon dhe zbaton rregullat e tregtisë në nivel global, si dhe shërben si forum për negociatat në reduktimin e pengesave në tregti. OBT u themelua në janar të vitit 1995. Në vitin 2015 kjo organizatë numëronte 161 vende anëtare. Funksionet e saj kanë shtrirje të gjerë, duke përfshirë administrimin e marrëveshjeve të dakorduara në kuadër të saj, pastaj trajtimin e kontesteve tregtare në mes të vendeve anëtare, monitorimin e politikave tregtare nacionale, ofrimin e asistencës teknike dhe të trajnimeve për vendet në zhvillim, si dhe kooperimin me organizatat e tjera ndërkombëtare. Anëtarësimi në OBT bëhet me konsensus të plotë të vendeve anëtare, ndërsa vendi anëtar duhet t'iu nënshtrohet në tërësi rregullave të

kësaj organizate në tregtinë e jashtme. Kosova për shumë vjet e ka synuar anëtarësimin në OBT, por ende nuk është ndërmarrë ndonjë hap konkret në këtë drejtim. (Petrit Gashi)

ORGANIZATA BOTËRORE E USHQIMIT (FAO). Agjenci e specializuar e Kombeve të Bashkuara për ushqim, e krijuar në vitin 1945. Selia e saj është në Romë. Që nga viti 2013 FAO-ja ka 197 anëtarë. Synon përmirësimin e prodhimit në bujqësi dhe ushqim në të gjitha pjesë të botës. FAO-ja ofron asistencë teknike për vendet në zhvillim, siguron informacione dhe kontribuon në harmonizimin e standardeve në fushën e të ushqyerit, të bujqësisë, të pylltarisë dhe peshkimit, duke përfshirë botimet e shumta në formë të raporteve periodike nga këto veprimtari. FAO-ja i këshillon qeveritë dhe siguron një hapësirë për debate shumëpalëshe rreth mundësive të sigurimit të ushqimit dhe të çështjeve themelore që lidhen me bujqësinë dhe sigurinë ushqimore. Në bashkëpunim me Organizatën Botërore të Shëndetësisë, FAO-ja zhvillon standardizimin ndërkombëtar të sistemit të të ushqyerit. Organizata është gjithashtu një burim i dijes dhe informacionit, duke ndihmuar vendet në zhvillim dhe vendet në tranzicion në procesin e modernizimit dhe përmirësimin e bujqësisë, të pylltarisë dhe të peshkimit. Pas luftës së fundit, FAO-ja ka filluar të veprojë edhe në Kosovë, së pari në formë të ndihmave emergjente për rimëkëmbjen e ekonomisë së fermerëve. Në bashkëpunim me Bankën Botërore, pos studimeve të ndryshme mbi shkatërrimet nga lufta, FAO-ja ka ndarë disa mijëra kafshë (kryesisht lopë mjelëse) për fermerët në tërë Kosovën, të cilët kanë pësuar dëme nga lufta në kapacitetet prodhuese. Në fazën zhvillimore, FAO-ja ka ofruar trajnime për rritjen dhe organizimin e prodhimitarëve bujqësorë si dhe rimëkëmbjen e infrastrukturës ekonomike dhe urbane në zonat rurale, si dhe të ngritjes së kapaciteteve institucionale në Kosovë. (Halim Gjergjizi)

ORGANIZATA HUMANITARE “CARITAS KOSOVA”. Organizatë humanitare e Kishës Katolike në Kosovë. U themelua në vitin 1992, me seli në Ferizaj. Gjatë viteve ’90 objektiv kishte shpërndarjen e ndihmave humanitare. Që nga viti 1999 “Caritas Kosova” u zhvillua me mbështetjen e organizatave anëtare të rrjetit “Caritas”, të cilat ishin të pranishme në

Kosovë gjatë periudhës së emergjencës. Pas fazës emergjente, projektet e ndryshme të “Caritas-it” ndërkombëtar janë integruar në strukturën “Caritas Kosova”. Që atëherë kjo organizatë u zhvillua gradualisht dhe realizoi një sërë aktivitete, që implementohen në tërë territorin e Kosovës. Organizata bashkëpunon me strukturat shtetërore dhe komunale të Kosovës, si dhe me Komisionin Europian, me agjencitë e Kombeve të Bashkuara që veprojnë në Kosovë dhe me fondacionet e tjera ndërkombëtare. Drejtor i “Caritas Kosovës” është dom Viktor Sopi. (Ndue Ukaj)

ORGANIZATA ILEGALE “BESA” (1935). Organizatë ilegale e studentëve shqiptarë në Beograd. U themelua në vitin 1935, në të cilën u inkuadruan shumica e studentëve shqiptarë. Në fillim në organizatë u përfshin studentët: Ejup Abdurrhman Shehu, Ymer Rashiti, Esat Doko, Shaip Mustafa, Shaip Kamberi, Abdullah Saqipi-Golimidolli, Selim Shabani, Esad Berisha, Tahir Ismail Ibrani, Nexhib Deva, Xhevdet Pallaska, Ibrahim Lutfiu, Sokol Dobroshi, Jahja Osmani etj. Me programin e saj organizata synonte ngritjen e vetëdijes kombëtare të shqiptarëve, për luftë kundër pushtetit të atëhershëm jugosllav. Qëllimi kryesor ishte ribashkimi i Kosovës dhe i viseve të tjera shqiptare me Shqipërinë. Krerët e organizatës bashkëpunuan me Legatën Shqiptare në Beograd. Brenda udhëheqjes së organizatës kishte dy grupe politike: krahu djathtist, nacionalist, dhe ai majtist, komunist. Këta të fundit nuk e përjashtonin mundësinë e bashkëpunimit me studentët serb të të njëjtës ideologji. Organizata veprroi deri në vitin 1941 (Illir Zylfiu).

ORGANIZATAT E STUDENTËVE. Formë e organizimit shoqëror të studentëve. Në sistemin monist studentët në Kosovë kishin vetëm një organizatë, Lidhjen e Rinisë Studentore, si dhe shoqata të ndryshme profesionale, kulturore, sportive etj. Në sistemin shoqëror pluralist studentët në Kosovë kanë disa organizata. Sipas Ligjit për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës (2011), krijimi i një ose më shumë organizatave studentore parashikohet në statutin ose me dokument tjetër të bartësve të arsimin të lartë, në mënyrë që ato të përfaqësojnë studentët dhe të kontribuojnë në plotësimin e kërkesave sociale, kulturore, akademike e

argëtuese të tyre. Numri më i madh i organizatave studentore është në Universitetin e Prishtinës. Të tilla janë: Unioni Shqiptar Studentor, “Reforma në Proces”, “Paqja Studentore”, Unioni i Pavarur Studentor, Opinioni i Pavarur Studentor, “Fryma e re Studentore”, “Vizioni”, Lista Studentore për Integrim, Unioni Studentor Proeuropian, “Studim, veprim, kritikë” etj. Organizatat e studentëve kanë organet e tyre drejtuese dhe përfaqësohen në Parlamentin Studentor dhe në Senatin e Universitetit. (Majlinda Gjellaj)

ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE TË ARSIMIT. Në rindërtimin, reformimin dhe zhvillimin e arsimit në Kosovë, nga fundi i shekullit XX, kontribut të veçantë dhanë një varg organizatash e institucioneve ndërkombëtare, qeveritare dhe joqeveritare. Në arsimin fillor dhe të mesëm qysh në vitin 1997 u angazhua Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (SOROS), ndërsa në arsimin e lartë nga viti 1998 u angazhua Agjencia Austriake e Arsimit Universitar në Botë (WUS). Në vitet në vazhdim, kontribut të veçantë dha Fondi Ndërkombëtar i Kombeve të Bashkuara për Ndhimë Fëmijëve (UNICEF), sidomos në rindërtimin e objekteve shkollore, pastaj Misioni Ndërkombëtar i Kombeve të Bashkuara për Kosovën (UNMIK), Këshilli i Europës, Organizata për Siguri e Bashkëpunim në Europë (OSBE), Projekti i Zhvillimit të Mësimdhënësve në Kosovë (KEDP) nga Kanadaja, Bashkëpunimi Teknik Gjerman (GTZ), Mbështetja Finlandeze për Zhvillimin e Sektorit të Arsimit në Kosovë (FSDK), Standardet dhe Njësia Matëse (SAU), Fondacioni “Kujdesi për fëmijët” (Save the children), si dhe dhjetëra organizata dhe agjenci të tjera, të cilat dhanë kontribut për avancimin e aspekteve të ndryshme të sistemit të arsimit në Kosovë. (Majlinda Gjellaj)

ORGANIZIMI I KISHËS MESJETARE. Organizimi i kishës në Kosovë para sundimit osman mund të ndiqet nga antikiteti i vonë dhe përgjatë mesjetës përmes burimeve historike, arkeologjike, etnologjike e onomastikës. Edikti i Milanos (313) kishte legalizuar edhe organizimin kishtar në Dardani. Përmes statusit të veçantë administrativ e juridik, provinca e Dardanisë kishte mitropolinë të sanksionuar me Konkilin e Nikesë (325). Kjo kishë do të jetë më vonë element i fortë i krishterimit të

ardhësve sllavë në Ballkan. Përgjatë shek. IV-V, organizimi kishtar në Iliri mori hov të madh: vërtet në Dardani u ngritën 5-7 ipeshkvi. Pas tërmetit të vitit 518, selia kishtarë kaloi nga Skupi te Justiniana Prima, e cila, sipas Novelës XI (prill 535), nga ipeshkvia u ngrit në rangun e argjipeshkvisë, ku përfshiheshin dioçezat: Dacia Mediterranea, Dacia Ripensis, Moesia Superior, Dardania, Prevalis, Macedonia Secunda dhe Panonia Secunda. Organizimi kishtar ishte realizuar sipas ndarjes administrative të Perandorisë Romake. Dyndjet e shek. V-VII u shoqëruar me dëme të mëdha dhe me ndërrimin e hartës kishtarë të Dardanisë (Skupi, Justiniana Prima, Justiniana Sekunda, Naisus e Remesiana). Dyndjet ndërprejnë edhe lidhjet me Papatin, për t’u shkëputur për një kohë më të gjatë sidomos nga mesi i shek. VIII, kur Iliriku Lindor iu bashkëngjiti Konstandinopojës. Jashtë ndikimit të kishës bizantine mbeten ende Ipeshkvia e Shkupit dhe e Prizrenit. Pas shkatërrimit të Justiniana Sekunda-s, kjo ipeshkvi mori ingerenca juridike e titullare. Në të vërtetë, edhe pse Ipeshkvia e Prizrenit përmendet në dokumentet e perandorit bizantin, Bazilit II (1019/1020), ka dëshmi të tërthorta se kjo ipeshkvi përmendet më herët (458), në kontekst të Konkilit të Kalcedonit (451). Ipeshkvia e Prizrenit, që përfshinte Rrafshin e Dukagjinit dhe Ipeshkvia e Lipjanit, që përfshinte Rrafshin e Kosovës, sipas dokumenteve të Bazilit II, kishte hyrë nën juridiksionin e Argjipeshkvisë së Ohrit. Ndikimi i kishës bizantine ishte i fuqishëm pas ndarjes së kishave (1054). Me zgjerimin e shtetit të Nemanjidve, u zgjerua edhe Kisha Ortodokse Serbe (KOS) me të gjitha tiparet që i zotëronte Kisha Ortodokse e Bizantit. KOS deri më 1219 ishte nën juridiksionin e Argjipeshkvisë së Ohrit. Me iniciativë të Shën Savës (1219), ajo u shpall e pavarur, me seli në Zhiçë të Rashës. Brenda saj u themelua Peshkopta e Hvosnës, me seli në Studenicë të Istogut. Pas sulmeve bullgarotataro-kumane (1253), selia e Zhiçës u bart në Pejë. Krahas shpalljes së Perandorisë së Serbisë (1346), kryepeshkopata u ngrit në shkallë të Patriarkanës Ortodokse me seli në Pejë. Aksioni i Papatit në Kosovë mori hov në veçanti nga fillimet e shek. XIII e sidomos në shek. XIV. Dokumentet njoftojnë për ekzistimin e famullive katolike në Kosovë: dokumenti (1303) i papës Benedikti XI (1303-1306), ndër pesë

famullitë katolike të Mbretërisë Nemanjide, përmend famullinë e Trepçës (*De Trepzo*) dhe të Graçanicës (*De Grazaniza*). Dokumenti (1346) i papa Klementit VI (1342-1352), për sufragan të Dioqezës së Ipeshkvisë së Kotorrit, përmend famullitë e Prizrenit, të Novobërdës, të Janjevës dhe të Trepçës. Interesimi i Papatit për katolikët shprehet sidomos në shek. XIV-XV. Papa Bonifaci IX (1398-1404), në vendin e zbrazur për ipeshkëv të Prizrenit zgjodhi dominikanin Georgium Pandusium (1404). Më vonë (1431), papa Eugjeni IV (1432-1447) dërgoi raguzanin Stojkoviç në koncilin kishtar të Bazelit. Papa synonte që përmes realizimit të unionit t'i përfitonte edhe famullitë e Kosovës. Më pastaj në këtë drejtim u angazhua edhe humanisti Gjini Gazulli. Me depërtimet osmane nga mesi i shek XV, famullitë romane të Kosovës do të kalojnë nga juridiksioni i Ipeshkvisë së Kotorrit nën atë të Argjipeshkvisë së Tivarit. (Jahja Drançolli)

ORGANIZIMI INSTITUCIONAL NË KOSOVË (1991-1999). Funksionimi institucional i rezistencës së Kosovës kundër pushtimit serb deri në luftën e vitit 1999. Pas suprimimit të autonomisë së Kosovës (më 23 mars 1989) dhe vendosjes së Kosovës nën pushtimin serb, filloi organizimi i rezistencës paqësore kundër këtij pushtimi, ndër të tjera, edhe me krijimin dhe vënien në funksion të disa institucioneve të Kosovës. Fillimisht, me krijimin e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) (dhjetor 1989), e pastaj edhe të partive të tjera shqiptare dhe të sindikatave të pavarura të Kosovës, u krijua embrioni i një lëvizjeje politike të rezistencës dhe të padëgjueshmërisë qytetare kundër pushtetit serb. Pas shpalljes së Kushtetutës së Kaçanikut (7 shtator 1990) dhe referendimit (tetor 1991), Kuvendi i Kosovës emigroi, ku krijoi edhe Qeverinë e Përkohshme. Jashtë vendit funksiononin disa ministri, si ajo e Financave, e Arsimit, e Punëve të Jashtme, e Mbrojtjes, e Punëve të Brendshme, e Informimit, të cilat financoheshin nga kontributet e diasporës. Me të ashtuquajturin "Fond i trepërqindshit" të bashkëkombësve tanë në botë, financohej buxheti i Qeverisë së Kosovës, përmes të cilit, pos këtyre ministrive, mbulohej po ashtu edhe funksionimi i institucioneve brenda në Kosovë, para së gjithash ato të arsimit në të tri nivelet. Në atë kohë funksiononte edhe Zyra e Kosovës në Tiranë dhe Zyra Informativ e Kosovës në

Gjenevë. Brenda kësaj periudhe ishin mbajtur dy zgjedhje parlamentare (1992 dhe 1998) dhe zgjedhjet presidenciale (1992), mirëpo as Kuvendi, as Qeveria e Përkohshme nuk vepruan brenda Kosovës, ndonëse në dy aksione të bastisjes së policisë serbe ishin arrestuar zyrtarë të lartë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Punëve të Brendshme të Kosovës. I vetmi institucion qendror funksional brenda në Kosovës ishte ai i presidentit të Kosovës, i ushtruar gjatë dy mandateve nga Ibrahim Rugova. Mirëpo, deri në shpalljen e Republikës së Kosovës, këto institucione të përkohshme nuk ishin njohur ndërkombëtarisht, as në rrafshin multilateral (nga organizatat ndërkombëtare) as në atë bilateral, pos një "gjysmë-njohjeje" të bërë me Rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë. Këto institucione ishin të rëndësishme për periudhën derisa Kosova ishte nën pushtimin serb dhe ushtronin më shumë pushtet moral sesa juridik dhe ekzekutiv. (Blerim Reka)

ORIENTALIZMAT. Fjalë, shprehje, thënie apo kompozim i ndonjëres nga gjuhët e Lindjes (arabishtes, turqishtes a persishtes) që përdoret në ndonjë gjuhë tjetër. Në gjuhën shqipe orientalizmat kanë depërtuar kryesisht nëpërmjet gjuhës turke, e cila në të kaluarën kishte huazuar më tepër fjalë arabe e persiane sesa që u ka dhënë atyre fjalët e veta. Sa i përket përdorimit të orientalizmeve në gjuhën shqipe, ato në shumicën e rasteve paraqiten me të njëjtin kuptim që kanë edhe në origjinal. Por, ndodh që të hasen edhe të tilla që kanë pësuar ndryshime morfologjike e semantike. Një numër i madh i tyre, përveç kuptimeve të para që dhanë në gjuhën shqipe, u përdorën dhe vazhdojnë të përdoren edhe sot e kësaj dite në një sërë idiomash e frazeologjizmesh dhe si të tilla janë përfshirë edhe në Fjalorin e gjuhës shqipe. Orientalizmat i kanë trajtuar në punimet e tyre: T. Dizdari, H. Kaleshi, F. Mehdiu, M. Polisi, J. Hundozi etj. (Jahja Hundozi)

ORKESTRA DHE KORI I FILARMONISË SË KOSOVËS. Formacione në kuadër të institucionit më të lartë dhe gjithëpërfshirës të muzikës në Kosovë, i themeluar pas vitit 2000, në kohën e ndryshimeve të mëdha që ndodhën në vend. Por zanafilla e këtij institucioni nisi më 1953 si Orkestër e Radio-Prishtinës dhe e qytetit të Prishtinës, orkestër harqesh, simfonike



ORKESTRA E FILHARMONISË SË KOSOVËS

a revyale me muziktarë vendorë dhe të huaj. Në këtë orkestër herë pas here përfshiheshin edhe anëtarë të orkestrës frymore të Shtëpisë së Armatës në Prishtinë. Orkestra udhëhiqej nga dirigjentë që vepronin në Prishtinë dhe në Shkup, kryesisht serbë e maqedonas. Ndërkaq, veprimtaria e mirëfilltë e Orkestrës Simfonike kishte nisur më 1974, si Orkestër Simfonike e Radiotelevizionit të Prishtinës (RTP), me dirigjent Bahri Çelën dhe më tutje me Bajar Berishën, me instrumentistë e këngëtarë vendorë, me bashkëpunime a huazime instrumentistësh nga hapësirat e ish-Jugosllavisë dhe jashtë saj. Ngritja e kësaj orkestre erdhi si rezultat i zhvillimeve të përgjithshme pozitive në Kosovë dhe i themelimit të një sërë institucioneve shoqërore, arsimore dhe kulturore. Në këtë kuadër, formimi i produksionit muzikor për incizime programesh muzikore me vepra kompozitorësh tanë dhe të huaj, me koncerte të Orkestrës në studion e RTP-së, në Sallën e Pallatit të Rinisë, në festivalin “Ditët e Muzikës Kosovare”, në “Tribunën e krijimtarisë muzikore jugosllave” në Opati, në “Lojërat Verore të Dubrovnikut”, në “Ditët e muzikës në Herceg-Novii” etj. Më pas, në fund të viteve ‘80 dhe përgjatë atyre ‘90, në periudhën e deinstitutionalizimit, u ndërpre edhe puna e kësaj orkestre. Ndërkohë, Koncerti i parë i Orkestrës Simfonike, drejtuar nga Bahri Çela, tanimë me emrin Filarmonia e Kosovës, u mbajt në vitin 2000, duke përjetuar në vitet vijuese një rritje graduale të anëtarëve me bashkëpunim instrumentistësh nga Shqipëria, me koncerte çdo muaj. Në periudhën vijuese u intensifikua bashkëpunimi me solistë dhe dirigjentë të ndryshëm, duke arritur të realizojë vepra orkestrale, vokalo-instrumentale, operistike, arie e vepra korale operistike, me qëllim formimin e trupës

së teatrit të operës. Po në këtë kohë u riformua dhe kori i Filarmonisë së Kosovës dhe u inskenuan operat “Goca e Kaçanikut”, “Dasma arbëreshe” të R. Dhomit, “Carmen” e Zh. Bizesë, duke u përforcuar me instrumentistë, solistë e dirigjentë nga Teatri i Operës e Baletit nga Tirana. Pas Antonio Gashit dhe Rauf Dhomit, nga 2006 e këtij Filarmoninë e udhëheq kompozitori dhe dirigjenti Baki Jashari, ndërsa Korin e Filarmonisë, i cili është është vazhdim i korit profesional të RTP-së, e drejton kompozitori dhe dirigjenti R. Rudi. Përpos incizimeve për programin muzikor të Radiotelevizionit të Kosovës, Orkestra dhe Kori i Filharmonisë së Kosovës vazhdon paraqitjet në festivale me vepra korale, pjesërisht vokalo-instrumentale autorësh të huaj e vendorë. Gjithashtu është arritur të shtohet bashkëpunimi me Filarmoninë e Maqedonisë dhe me institucionet muzikore të Shqipërisë, duke e kompletuar Orkestrën me instrumentistë, me angazhimin e rregullt të dirigjentit japonez, T. Yanagisawa, si dhe të solistëve dhe dirigjentëve të huaj dhe shqiptarë (Han, Krantja, Papavrami, Koço, Badivuku etj.). (Zeqirja Ballata)

ORKESTRA SIMFONIKE E RTV-PRISHTINA. U themelua në vitin 1953 dhe për një kohë nuk kishte status të qartë dhe as përbërje stabile. Fillimisht kryente rolin e orkestrës vullnetare a amatore. Konsiderohej Orkestër e qytetit të Prishtinës, pastaj Orkestër e Radio Prishtinës. Herë-herë ishte orkestër e harqeve apo orkestër revyale për nevojat e gjinive të ndryshme muzikore dhe jo vetëm për krijimtarinë të mirëfilltë muzikore artistike. Vendimi për të ekzistuar dhe vepruar një formacioni i tillë ishte i organeve përgjegjëse të atëhershme shoqëro-ro-politike të Kosovës. Fillimisht, më 1953 Orkestrën e Radio-Prishtinës e drejtonin dirigjentët që vepronin në Prishtinë, si B. Vojnoviq, më pas O. Ristiç, T. Petronja. Kohë pas kohe vinin dhe nga qendrat e afërta (Shkup, Nish) dhe realizonin vepra me kërkesa tekniko-artistike relativisht modeste, si arie të popullarizuara operetash e operash të autorëve të huaj, shpesh me tekste të përshtatura në gjuhën shqipe. Nga gjysma e dytë e viteve ‘50 muziktarë të paktë vendorë vepronin si punonjës të Radio-Prishtinës, por edhe si kompozitorë aktivë, duke përpunuar e krijuar valle, rapsodi, suita për orkestrën e atëhershme simfonike të Radio-Prishtinës, siç ishin Lorenc

Antoni (1909-1991) dhe Rexho Mulliqi (1923-1982). Pavarësisht nga kushtet dhe mungesa e instrumentistëve dhe drejtuesve të orkestrës kishin filluar tashmë të dalin një plejadë pedagogësh, kompozitorësh, instrumentistësh e dirigjentësh vendorë, të cilët kishin një përkrahje më të gjerë të institucioneve vendimmarrëse, veçmas atyre të kulturës. Më 1974 u mor vendimi për (ri)formimin e Orkestrës Simfonike të Radiotelevizionit të Prishtinës, fillimisht me një përbërje kamerale, ndërsa së shpejti e zgjeruar dhe e përforcuar me instrumentistë të huazuar, e drejtuar nga dirigjenti i parë i diplomuar, Bahri Çela. Ky vendim luajti rol definitiv për mëkëmbjen e Orkestrës Simfonike të RTV-Prishtina, zhvillimin e jetës koncertale dhe mundësoi ekzekutimin e veprave të autorëve kosovarë, por dhe për të nxitur krijimin e veprave të reja orkestrale, vokalo-instrumentale dhe muzikore-skenike. Orkestra simfonike në vijim iu besua dirigjentit të ri, Bajar Berisha (1975), i cili për afro 16 vjet punoi me sukses dhe realizoi shumë vepra orkestrale e vokale-instrumentale jo vetëm të kompozitorëve të huaj, por edhe të autorëve tanë, si të L. Antonit, R. Mulliqit, Z. Ballatës, R. Dhomi etj. (Zeqirja Ballata)

ORLLANI. Fshat në komunën e Podujevës, rreth 25 km në juglindje të qendrës komunale. Është vendbanim i tipit të shpërndarë. Sipërfaqja e territorit të fshatit është 1,692 ha. Përmendet në disa dokumente të shkruara mesjetare. Në defterin kadastral të vilajetit Vëllk (1455) përmendet si vendbanim me 6 shtëpi. Deri në vitin 1965 fshati kishte statusin e qendrës administrative komunale për trevën e Gollakut. Pas këtij viti, me ndarjen e re administrative, Orllani e humb këtë funksion, ndërsa hapësira gravituese e kësaj qendre komunale i bashkohet komunës së Prishtinës dhe Podujevës. Popullsia merret me bujqësi dhe blegtori, me shërbime hoteliere etj. Sipas vlerësimit të vitit 2000, fshati ka rreth 1,300 banorë. (Skender Halimi)

OROSHI-BERISHAJ Violeta (1962-). Gazetare. Lindi në Prishtinë. Shkollën fillore dhe të mesme, si dhe studimet në Fakultetin Juridik i mbaroi në Prishtinë. Punën e gazetares e filloi në Radiotelevizionin e Prishtinës në vitin 1982. Në vitin 1990 ishte shefe e redaksisë së Televizionit YUTEL për Kosovën. Nga viti 1992

deri më 2004 punoi korrespondente nga Kosova për TV britanike WTN, për Radion WDR dhe Radion "Deutsche Welle" të Gjermanisë. Ndërkohë, më 1993 bëhet kryeredaktore-koordinatore e Agjencisë AIM (Alternative Information Network), me selinë qendrore në Paris dhe hap redaksinë e saj në Prishtinë. Në kuadër të Agjencisë AIM realizoi projektin për trajnimin e gazetarëve të rinj. Po në këtë periudhë bëri një sërë shkrimesh autoriale për gazeta dhe revista të pavarura në Serbi dhe Mal të Zi, ndërsa në periudhën 1996-1999 ishte korrespondente nga Kosova e Radio B-92 në Beograd. Në periudhën 2004-2011 ishte korrespondente e BBC-së. Punon për Radio WDR me seli në Këln, si korrespondente nga Kosova. (Ibrahim Berisha)

ORTEKËT E BORËS. Lëvizje e shpejtë e masës së borës në shpatet e pjerrëta. Pas fillimit të ortekut, shpejtësia rritet në mënyrë të vullshme rritet vëllimi i borës, duke shkatërruar gjithçka përpara. Faktorët që shkaktojnë formimin e ortekëve janë: morfologjia e terrenit, pjerrtësia, sasia e borës, mungesa e vegetacionit etj. Në lindjen e ortekëve mund të ndikojë edhe njeriu. Zakonisht paraqiten në shpate të zhveshura me pjerrtësi prej 25-60°. Ortekët mund të shkaktojnë humbje në njerëz dhe dëme materiale. Masa mbrojtëse kundër ortekëve është pyllëzimi i sipërfaqeve, vendosja e pritave mbrojtëse, aktivizimi i qëllimshëm etj. Në Kosovë kushtet më të favorshme për formimin e ortekëve janë në Beshkët e Nemuna dhe në Malet e Sharrit. Ndër ortekët më të mëdha të ndodhura në Kosovë janë: orteku i Koshutanit (1981), i Restelicës (2012), i Brezovicës (1981, 2015) etj. (Valbon Bytyçi)

ORTOGRAFIJA E VITIT 1964. Ortografia e parë dhe e fundit që u hartua për gegërishten dhe u aprovua pavarësisht dhe në mënyrë të ndarë nga aktiviteti që zhvillohej në Shqipëri. Në raport me rregullat gjithësesi të pamjaftueshme të viteve 1952 dhe 1957, ortografia e vitit 1964 paraqet një hap përpara, u hartua në një shkallë më të lartë shkencore dhe përfaqëson nivelin e zhvillimit të gjuhës letrare shqipe në Kosovë, Maqedoni e në viset e tjera etnike shqiptare në ish-Jugosllavi. Hapi më i madh përpara qëndron në tendencën për t'i afruar sa më shumë zgjidhjet konkrete me ato që ishin shpallur në ortografinë e 1956-s në Tiranë.

Ortografia e vitit 1964 i hapte rrugën njësimi të drejtshkrimit të shqipes. Kryetar i Komisionit për hartimin e kësaj ortografie ishte Idriz Ajeti. Kjo ortografi ndahet në tri pjesë: fonetikë, morfologji dhe “të ndryshme”. Kapitulli i fonetikës trajtonte mjaft gjerë të gjitha zanoret dhe togjet e tyre, bashkëtingëlloret, gupet e bashkëtingëlloreve, theksin, apostrofin etj. Në kapitullin e morfologjisë trajtoheshin kategoritë leksiko-gramatikore (emri, mbiemri, përemri, numërori, folja, ndajfolja dhe lidhëza); parafjala e pasthirrma si dhe pjesëza nuk u trajtuan fare. Sistemi emëror përfshihej në mënyrë shumë të gjerë. Te kategoria e mbiemrave bëhej fjalë për mbiemrat me *-të*, *-ëm*, *-shëm*, si dhe për mbiemrat me *-ël*, *-er*. Një vend i veçantë iu caktua kategorisë së numërorëve. Kjo ortografi trajtoi edhe përemrat vetorë, dëftorë, pronorë, lidhorë, pyetës dhe të pacaktuar. Në kapitullin që u kushtohej foljeve bëhej fjalë për të gjitha mënyrat e kohët si dhe për trajtat dhe diatezat e tyre. Në radhën e ndajfoljeve trajtoheshin ato të vendit, të kohës dhe të mënyrës. Me kategorinë e lidhëzave mbyllej kapitulli që i kushtohej morfologjisë. Pjesa e tretë e kësaj ortografie, që titullohej “Të ndryshme”, përfshinte rregullat e përdorimit të shkronjave të mëdha, shkrimin e emrave të popujve, të stinëve të vitit, të muajve, të ditëve të javës, titujt e institucioneve, emrat gjeografikë, emrat e shteteve etj. Po ashtu trajtoheshin emrat e përveçëm të huaj, datat dhe ndarja e fjalëve në rrokje. Respektimi i parimit fonetik, morfologjik dhe në disa raste edhe i parimit historik dhe tendenca për ruajtjen sa më të plotë të trajtave të shkruara, janë veçoritë kryesore të kësaj ortografie, e cila luajti rol të rëndësishëm për zhvillimin e gjuhës letrare shqipe. (Shkumbin Munishi)

ORUÇAJ Enver (1962-). Pjesëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), komandant i Brigadës 142 i Zonës Operative të Shalës. Lindi në Skënderaj. Kreu shkollën e mesme të policisë në Vushtrri (1981), ndërsa Akademinë Ushtarake në Sarajevë (1987). Një kohë punoi si instruktor dhe pas përfundimit të studimeve u emërua komandant në Shkollën e Policisë në Vushtrri. Në vitin 1990, pas suprimimit të autonomisë së Kosovës, braktisi punën në policinë e Kosovës. Me fillimin e luftës çlirimtare u inkuadrua në radhët e UÇK-së. Në qershor të vitit 1998 u emërua komandant i Brigadës 142 të Zonës Operative të Shalës.

Në shenjë hakmarrjeje për angazhimin e tij në radhët e UÇK-së, policia serbe më 20 mars 1999 ia ekzekutoi vëllanë, Ilazin, në prani të familjes. Pas përfundimit të luftës u angazhua në detyra të ndryshme në institucionet e Kosovës, kryesisht në fushën e rendit dhe të sigurisë. (Sylë Ukshini)

ORUÇI Bahri (1930-2011). Politikan. Lindi në Mikushnicë të Mitrovicës. Pas shkollimit bazë, kreu Shkollën e Lartë Politike dhe u bë anëtar i Partisë Komuniste të Jugosllavisë në vitin 1949. Që herët ushtroi funksione të ndryshme partiake dhe shtetërore në komunën e Mitrovicës, në organet dhe organizatat krahinore, të Republikës së Serbisë dhe të ish-Federatës Jugosllave. Një kohë ishte drejtor gjeneral i kombinatit “Trepça”. Në vitet 1978-1981 ishte kryetar i Këshillit Ekzekutiv të KSA të Kosovës, kur dha dorëheqje për shkak të demonstratave të vitit 1981. Vdiq në Ulqin. (Ali Cenaj)

OSEKU Shefki (1943-). Shkrimtar. Lindi në Gjakovë. Kreu shkollimin fillor dhe të mesëm në vendlindje, ku më pas mbaroi edhe Shkollën e Lartë Pedagogjike në Gjakovë, pastaj vazhdoi studimet në degën përkatëse të Fakultetit Filologjik të Universitetit të Prishtinës. Më vonë kreu edhe Fakultetin Juridik dhe zuri punë si jurist në komunën e Gjakovës. Në vitin 1989 emigroi në Suedi. Në fillim punoi si përkthyes në zyrat për të huaj dhe më vonë mësues i gjuhës shqipe. U mor me hartimin e teksteve shkollore për mësim plotësues të fëmijëve shqiptarë dhe ishte bashkëpunëtor i disa të përkohshmeve në diasporë. Më 1995 themeloi dhe udhëhoqi revistën shqip-suedisht “Drita” në Trelleborg, në kuadër të së cilës botoi edhe një numër librash të autorëve të ndryshëm. Deri më tani ka botuar përmbledhjen me poezi “Një lloj tjetër drite” (1997) dhe romanet “Hetimet” (2000) dhe “Ushtari i vonuar” (2012). Bën edhe përkthime të poezisë shqipe në gjuhën suedeze. (Shaip Beqiri)

OSMANAJ Sylë (1941-). Shkrimtar, gazetar. Lindi në fshatin Kuqishtë të Rugovës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje dhe në fshatin Haxhaj, shkollën e mesme në Pejë, kurse studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin Filozofik në Prishtinë. Në atë periudhë u mor edhe me veprimtari teatrale.

Një vit punoi si mësimdhënës në Shkollën e Mesme Ekonomike të Pejës. Nga viti 1969 punoi si gazetar në të përditshmen “Rilindja” të Prishtinës. Për një kohë të gjatë punoi në rubrikën e kulturës, ku ishte kronist i ngjarjeve kryesore në këtë fushë, autor i shumë intervistave me personalitete të rëndësishme të jetës kulturore, komentator dhe analist i dukurive dhe i rrjedhave kulturore të ne. Dha një ndihmesë të rëndësishme edhe në redaktimin gjuhësor të shumë teksteve shkollore të Shtëpisë Botuese “Dukagjini” të Pejës. Shkroi për të rritur dhe për fëmijë, kryesisht tregime dhe drama. Pos tjerash, botoi (së bashku me Ali R. Berishën) edhe monografinë “Trimi i mirë me shokë shumë”, për grupin dramatik të studentëve të periudhës 1965-1967 (2012). Veprat e botuara: “Kaltërsi dhe shi” (1978), “Tisi i rrëfimit” (1980), “Shënjestra e syve” (1988) etj. (Arif Demolli)

OSMANAJ Shaban (1945-1988). Mbledhës i folklorit shqiptar, poet. Lindi në Lisna Bore të Anës së Malit (Ulqin). Shkollën fillore e kreu në Sukubinë dhe në Katërkollë, kurse Normalen në Mitrovicë. Kreu studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin e Filologjisë në Beograd. Pas diplomimit në vitin 1973, punoi si mësimdhënës i gjuhës shqipe në Shkodër, Katërkollë dhe në Ulqin. Ishte mbledhës i pasionuar dhe i kujdesshëm i folklorit, që kur ishte nxënës i shkollës së mesme e deri në ditët e fundit të jetës. Përmbledhja e tij folklorike “Këngë popullore nga Ulqini dhe Ana e Malit”, e botuar pas vdekjes (1989), është vepër me vlerë për artin popullor shqiptar të trevës së Anës së Malit dhe të Ulqinit. Pas vdekjes u botuan edhe dy vepra të tij, “Një yll pranë detit” (poezi, 1994) dhe “Ti Tahir a po vjen me gju (dramë, 2011). (Ylberza Halili)

OSMANËT E RINJ. Lëvizje politike e intelektualëve turq e shek. XIX. Njiheshin si “Osmanë të rinj” (Jeni Osmanllëllar). U themelua në Stamboll në vitin 1865, nga disa intelektualë përparimtarë, si Namik Kemal, shkrimtar e iluminist i shquar turk, ithtar i rendit kushtetues, pastaj Reshat Pashazade Ajetullahu, Nuri Pashazade Ajetullahu, Suphi Pashazade, Ali Suavi Efendiu, Zija Pasha, Ebuzija Tevfiku etj. Synimi kryesor i programit të kësaj organizate ishte shndërrimi i regjimit absolutist që sundonte në Perandorinë Osmane

në një monarki kushtetuese, ku pushteti i sulltanit do të kufizohej me kushtetutë dhe me parlamentin turk. Organizata synonte të shmangte vendosjen e kontrollit të Fuqive të Mëdha mbi Perandorinë Osmane dhe ta fuste atë në rrugën e zhvillimit. Në radhët e saj u bashkuan rreth 350 anëtarë, shumica e të cilëve ishin veprimtarë të njohur, publicistë, nëpunës të ndryshëm, gazetarë, funksionarë të lartë të aparatit shtetëror etj. Në radhët e tyre kishte njohës të mirë të kulturës dhe zhvillimeve politike në Europë, që kishin marrë pjesë edhe në Revolucionin Francez. Për realizimin e programit të tyre, “Osmanët e rinj” u përpoqën të arrinin një marrëveshje me sulltan Abdyl Azizin, duke e bindur atë të pranonte nxjerrjen e kushtetutës. Në vitin 1867 tërhoqën pas vetes komandantë të lartë ushtarakë dhe të xhandarmërisë në Stamboll dhe tentuan një komplot, i cili u zbulua para se të vihej në jetë. Pas kësaj, një pjesë e “Osmanëve të rinj” u burgosën. Të tjerët u arratisën në Europë. Të gjithë ata që dyshoheshin se kishin marrë pjesë në organizatën e tyre u përndoqën nga sulltan Abdyl Azizi. (Teki Kurti)

OSMANI Abdyl (1942-2005). Kimist, profesor universitar. Lindi në Morinë të Gjakovës, shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa maturën e përfundoi në Prishtinë. U diplomua në Fakultetin e Shkencave Natyrore në Universitetin e Shkupit. Kreu studimet pasuniversitare dhe mbrojti tezën e doktoratës në Universitetin e Zagrebit (1976). Në vitin 1970 u angazhua si asistent për lëndën e biokimisë në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës. Për shumë vjet ishte anëtar i këshillit botues dhe i redaksisë së revistës shkencore “Biokimia mjekësore jugosllave”, që botohej në Zagreb. Së fundi ishte profesor ordinar i Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë. Botoi dy tekste universitare dhe një numër punimesh profesionale dhe shkencore brenda dhe jashtë vendit. (Binak Kastrati)

OSMANI Bardhyl (1972-2001). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) dhe i Ushtrisë Çlirimtare për Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë (UÇPMB), dëshmor. Lindi në Preshevë. Kreu shkollën e mesme në vendlindje, ndërsa studimet për arkitekturë në Universitetin e Prishtinës. Në vitin 1999 u bashkohet radhëve të UÇK-së, duke vepruar

në Zonën Operative të Pashtrikut. Me fillimin e luftës në Luginën e Preshevës u bë pjesë aktive e organizimit të UÇPMB-së dhe e strukturave të saj komanduese. Udhëhoqi me sukses betejën e UÇPMB-së në Shoshajë të Preshevës. Më 14 maj 2001, derisa merrte pjesë në transportimin e të plagosurve nga beteja e Rahovicës për në Maxhere, u vra te penda e Rahovicës. (Fehari Ramadani)

OSMANI Fadbi (1954-). Pedagog, profesor universiteti. Lindi në Raven të Gostivarit, shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje. Studioi pedagogjinë në Fakultetin Filozofik të Prishtinës, magjistroi dhe doktoroi në Universitetin e Shkupit. Karrierën profesionale e filloi në vitin 1977 si mësimdhënës i lëndëve pedagogjike në gjimnazin e Gostivarit. Vazhdoi pedagog shkolle, drejtor i entit për punësim në Gostivar, mësimdhënës në Universitetin e Tetovës, ku ushtroi edhe funksione të ndryshme. U angazhua mësimdhënës edhe në Fakultetin Pedagogjik në Shkup dhe në Fakultetin e Edukimit të Universitetit të Prishtinës. Mori pjesë në konferenca shkencore vendore e ndërkombëtare. Është autor ose bashkautor i disa punimeve shkencore-profesionale dhe i botimeve që trajtojnë çështjen e mësimin: “Individualizimi i mësimin dhe mundësitë e realizimit në shkollimin e mesëm të gjimnazit” (2005), “Individualizimi i mësimin dhe reformat e arsimit të mesëm” (2009), “Sistemi i vlerësimit në funksion të procesit mësimor” (2010) etj. (Hajrullah Koliqi)

OSMANI Faton (1957-). Gazetar. Lindi në Besi të Prishtinës. Shkollimin fillor e kreu në vendlindje, gjimnazin në Prishtinë, ku përfundoi edhe studimet për ekonomi, ndërsa studimet master në “Imperial College” të Londrës. Disa vjet ishte gazetar dhe redaktor, fillimisht në “Bota e re” (1978-1980), pastaj në “Rilindje” dhe “Bujku” (1982-1999). Në periudhën 1983-1986 ishte korrespondent i “Rilindjes” në Beograd. Më 1986 u zgjodh ndihmësdrejtor në Entin Krahinor të Planifikimit Shoqëror të Kosovës. Nga viti 2001 u punësua në institucionet e Kosovës: në Ministrinë e Shërbimeve Publike (2002-2003), në Ministrinë e Bujqësisë dhe të Zhvillimit Rural (2004-2009) dhe më pas në Bankën e Biznesit. Në vitin 2009 emërohet konsull i Kosovës në Mbretërinë e Bashkuar në Londër

(2009-2014) dhe më pas konsull në Mbretërinë e Suedisë në Stokholm. (Artan Krasniqi)


OSMANI Hysni (1959-). Inxhinier i makinerisë, profesor universiteti. Lindi në Hajkobillë të Prishtinës. Shkollën fillore, të mesme dhe Fakultetin Teknik i kreu në Prishtinës. Kreu



HYSNI OSMANI

studimet pasuniversitare në Fakultetin e Makinerisë në Shkup (1990), ndërsa disertacionin e mbrojti në Fakultetin e Makinerisë të Universitetit të Prishtinës (UP) (1997). Fillimisht punoi në Korporatën Elektroenergjetike të Kosovës, kurse nga viti 1984 punon në Fakultetin e Makinerisë (tani Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike) të UP-së. Në vitin 1998 u zgjodh profesor asistent dhe në vitin 2004 profesor i rregullt për lëndët përpunimi termik dhe materialet mekanike. Ushtroi funksione të ndryshme në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike, ishte drejtor i Laboratorit Qendror të UP-së (2002-2005), pastaj prorektor i UP-së, anëtar i Këshillit Profesional të Standardizimit (2015) etj. Botoi një sërë punimesh shkencore në revista të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, pastaj projekte, elaborate, kumtesa etj. Është autor i disa teksteve universitare: “Përpunimi termik” (1999), “Materialet mekanike” (2004), “Teknologjia prodhuese në mekatronikë” (2011) etj., pastaj i dispensave dhe i një sërë punimesh shkencore të botuara brenda dhe jashtë vendit. Mori pjesë në simpoziume dhe konferenca shkencore, kreu disa projekte për nevojat e ekonomisë nga lëmi i makinerisë dhe mban ligjërata në Universitetin e Tetovës dhe në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë. (Fejzullah Krasniqi)

OSMANI Ibrahim (1950). Gazetar. Lind në fshatin Makresh i Ulët të komunës së Gjilanit. Kreu Fakultetin e Shkencave Politike në Universitetin e Zagrebit dhe studimet pasuniversitare në fushën e politikologjisë. Punoi për shumë vjet gazetar, redaktor dhe anëtar i kolegjiut të së përditshmes zagrebase “Vjesnik”. Ishte edhe redaktor i faqes javore, e cila botohej në gjuhën shqipe (“Vjesniku për kosovarët në botën e jashtme”). Një kohë ishte edhe korrespondent i gazetës “Rilindja” nga Kroacia.



IBRAHIM OSMANI

të Kosovës ishte kryeredaktor i parë i "Radio Kosovës", më pas supervisor i së përditshmes "Koha ditore". Gjatë viteve '90, sa ishte korrespondent, disa herë u arrestua dhe u keqtrajtua nga policia serbe, ndërkaq në vitin e suprimimit të autonomisë së Kosovës më 1989, u mbajt në izolim për më shumë se shtatë muaj. Për represionin ndaj shqiptarëve botoi librin "Tunelet e tmerrit". (Shefqet Rexhepi)

OSMANI Izedin (1924-2011). Mjek, pediatër, profesor universiteti. Lindi në Prishtinë, shkollimin e filloi në Prishtinë dhe më pas e vazhdoi në Medresenë e Shkupit (1941). Së fundi u diplomua në Shkollën Normale "Sami Frashëri" në Prishtinë (1944). Kreu studimet në Fakultetin e Mjekësisë në Beograd (1952). Më 1953 filloi punën në Spitalin e Përgjithshëm të Prishtinës, si mjek i përgjithshëm.



IZEDIN OSMANI

Specializimin nga pediatria e kreu në Beograd dhe më pas mori detyrën e shefit të repartit të pediatriisë. Në ato vite ishte i angazhuar edhe si mësimdhënës i lëndës së higjienës në gjimnazin e Prishtinës, kurse më 1962 u zgjodh mësimdhënës në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prishtinë, në drejtimin e edukatës fizike për lëndën biologjia e zhvillimit të njeriut dhe sporti. Në periudhën 1968-1972 ishte drejtor i Spitalit të Përgjithshëm në Prishtinë. Ishte kryetar i Shoqatës së Mjekëve të ish-Jugosllavisë dhe kryetar i Shoqatës së Pediatërve të Jugosllavisë. Ishte njëri nga nismëtarët e hapjes së Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë (1969), ku u zgjodh mësimdhënës për lëndën e pediatriisë. Në vitin 1975 mbrojti disertacionin e doktoratës. Po këtë vit mori edhe titullin profesor i lëndës së pediatriisë dhe u zgjodh dekan i Fakultetit të Mjekësisë (1975-1977). Publikoi dhe prezan-

toi shumë punime shkencore në ish-Jugosllavi dhe jashtë saj dhe ishte bashkautor i tekstit universitar në nivel jugosllav "Pediatria klinike" (1987). Kur mjekët shqiptarë u larguan nga puna me dhunë, ai vazhdoi mësimdhënien në Fakultetin e Mjekësisë (1992-1999). Pas luftës u rikthye në Klinikën Pediatrike dhe punoi deri në vitin 2001, kur u pensionua. (Isuf Dedushaj)

OSMANI Jusuf (1948-). Arkivist, gjeograf. Lindi në fshatin Sllatinë e Madhe të Fushë-Kosovës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, të mesmen në Prishtinë, Shkollën e Lartë Pedagogjike në Gjakovë dhe më pas Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës (1972). Në Zagreb kreu studimet pasuniversitare, ndërsa tezën e disertacionit të doktoratës në fushën e arkivistikës e mbrojti në Universitetin e Lubjanës. Deri në vitin 1999 punoi në Arkivin Komunal të Prishtinës, ndërsa nga vitit 2000 deri më 2011 ishte drejtor i Arkivit të Kosovës, përkatësisht kryeshef i Agjencisë së Arkivave të Kosovës. Deri më tani ka botuar një sërë veprash dhe artikujsh publicistikë, nga të cilat veçojmë: "Lënda arkivore për kolonizimin dhe reformën agrare në Kosovë 1918-1941" (1996), "Kolonizimi serb i Kosovës" (2000), 20 vëllime me emërvendet e vendbanimeve të Kosovës (2003-2007), "Mbrojtja dhe ruajtja e lëndës arkivore" (2007), "Krimet e Serbisë në Kosovë 1998-1999" (2010), "Krimet e Serbisë ndaj fëmijëve në Kosovë 1998-1999" (2011), "Çerkezët në Kosovë (2014) etj. Mori pjesë me kumtesa në shumë tubime shkencore dhe profesionale brenda dhe jashtë vendit. (Fitim Rifati)

OSMANI Nazmi (1961-1999). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), dëshmor. Lindi në fshatin Elezaj të komunës së Kaçanikut. Punoi në policinë e Kosovës deri më 1990. Në radhët e UÇK-së u inkuadrua në gusht të vitit 1998. Mori detyrën për mobilizimin e ushtarëve të rinj dhe furnizimin e tyre me armë. Me formimin e Brigadës 162 "Agim Bajrami" në Kaçanik dhe shtrirjes së njësiteve në tërë territorin e Kaçanikut, u bë pjesë e kësaj brigade. Arrin të shtrijë pozicionimin e UÇK-së edhe në fshatin Biçec. Kur forcat serbe filluan rrethimin e pikave të UÇK-së, komandant N. Osmani, në bashkëpunim me komandën e batalionit të parë përforcoi pozicionet dhe i përballoi sulmet e forcave armike. Në luftë e

sipër ai u vra nga forcat serbe më 25 mars 1999. (Skender Lutfiu)

OSMANI Rexhep (1950-). Veprimtar i arsimit, ministër dhe deputet. Lindi në Slatinë të Madhe (Fushë Kosovë), ku mori edhe arsimin fillor. Mbaroi normalen në Prishtinë, studioi për gjuhë e letërsi në Fakultetin e Filologjisë në Prishtinë, ku edhe magjistroi. Doktoroi më 2012 në shkencat gjuhësore në Qendrën e Studimeve Albanologjike në Tiranë. Fillimisht ishte mësues, pastaj mësimdhënës i gjuhës dhe i letërsisë shqipe, zëvendës drejtor dhe drejtor i shkollës ekonomike, këshilltar i arsimit në Entin Pedagogjik të Kosovës, kur e kundërshtoi projektin e “bërthamave të përbashkëta”, për çka u suspendua nga puna (1987). Veprimtarinë në fushën e arsimit shqip do ta intensivkojë gjatë viteve nëntëdhjetë. Në vitin 1990 u zgjodh kryetar i Lidhjes së Arsimitarëve Shqiptarë “Naim Frashëri”, ku u angazhua për mbijetesën dhe pavarësimin e arsimit shqip në Kosovë (1991-1999). Ishte anëtar i grupit të bisedimeve për arsim në Gjenevë (1991-1996), anëtar i grupit 3+3 për arsim me ndërmjetësimin e Fondacionit “Shën Exhidio” (1997). Në vitin 1999 emërohet zëvendësbashkëdrejtues në departamentin e arsimit dhe të shkencës në administratën e UNIMIK-ut, ndërsa pas zgjedhjeve u bë ministër i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë. Në dy mandate ishte deputet në Kuvendin e Kosovës. Në vitin 2007 u angazhua si mësimdhënës në Fakultetin e Edukimit, më pas u zgjodh profesor asistent në Universitetin e Prizrenit. Botoi punime nga fusha e arsimit dhe ajo e gjuhësisë, që i përmbodhi në dy vëllime me titull “Shkrime, intervita, artikuj...”. Për kontributin e tij në fushën e arsimit shqip në Kosovë mori çmime dhe mirënjohje. (Hajrullah Koliqi)

OSMANI Rufi (1960-). Politikan. Lindi në fshatin Çajlë të Gostivarit, Maqedoni. Diplomoi për Ekonomi në Universitetin e Prishtinës, ku kreu edhe studimet pasuniversitare dhe doktoroi në vitin 2005. Në vitin 1994 u zgjodh deputet në Kuvendin e Maqedonisë. Dy vjet më vonë u zgjodh kryetar i Gostivarit. Gjatë kësaj kohe u angazhua në mënyrë institucionale për përdorimin zyrtar të flamurit kombëtar shqiptar në Maqedoni. Në ngjarjet e korrikut të vitit 1997 u arrestua dhe u dënua me 14 vjet burg. Pas miratimit të ligjit për amnisti



RUFI OSMANI

në vitin 1999, u lirua nga burgju. Pas daljes nga burgju largohet nga Partia Demokratike Shqiptare dhe i kthehet jetës akademike. Ka botuar shumë libra dhe studime nga fusha e ekonomisë. Që nga themelimi i Universitetit të Tetovës (1994) ishte i përfshirë në procesin e mësimdhënies. Është profesor në Universitetin e Europës Juglindore në Tetovë. Në zgjedhjet e 22 marsit 2009 u zgjodh sërish prefekt i komunës së Gostivarit. Në vitin 2012 themeloi partinë e tij, Rilindja Demokratike, e cila fitoi dy mandate në Kuvendin e Maqedonisë. Pas humbjes në zgjedhjet e fundit lokale, dha dorëheqje nga kjo parti. (Arsim Sinani)

OSMANI Shefik (1923-2012). Pedagog, aktivist i arsimit, punonjës shkencor. Lindi në Shkodër, ku kreu edhe shkollën fillore dhe të mesme. Studimet i filloi për mjekësi në Itali, por u diplomua për pedagogji dhe gjuhë e letërsi shqipe në Universitetin e Tiranës. Karrierën pedagogjike e nisi më 1955 si mësues në Shkodër dhe e vazhdoi si drejtor shkolle, inspektor arsimit, drejtues dhe redaktor tekstesh shkollorë, bashkëpunëtor shkencor në Institutin e Studimeve Pedagogjike (Tiranë) etj. Sh. Osmani dha kontribut të veçantë për mësimin plotësues shqip në diasporë. Nga Ministria e Arsimit dhe e Kulturës e Kosovës u angazhua për udhëheqjen e grupit për hartimin e planit dhe programit mësimor për mësimin plotësues në diasporë (1993). Ishte edhe bashkautor dhe redaktor i ciklit të teksteve mësimore shqipe për nxënësit jashtë atdheut: “Zemra ime”, “Shkollë e jetë”, “Leximi im 3 dhe 4 në gjuhën amtare”, “Fletore pune për leximin 3 dhe 4”, “Plotësori i abetares”, “Fjalor me figura”, të botuar në periudhën 1994-2008. U mor edhe me studimin e arsimit shqip në diasporë (Zvicër). Sh. Osmani u shqua edhe si punonjës shkencor. Përveç artikujve të shumtë profesionalë-shkencorë, ai është autor i disa veprave të veçanta: “Fjalor i pedagogjisë” (1983), “Pjetër Bogdani” (1996), “Reflektse etnopedagogjike” (1998), “Naim Frashëri-Vepër letrare pedagogjike” (2001), “Shpalime etnopedagogjike” (2008) etj. Është bashkautor i disa veprave pedagogjike: “J. H. Pestaloci

reformator i madh i arsimit” (1977), “Historia e arsimit dhe mendimit pedagogjik shqiptar” (2003) etj. Për kontributin e tij në fushën e arsimit dhe të mendimit pedagogjik u nderua me çmime dhe mirënjohje. Ishte bartës i titullit “Mësues i Merituar”. (Nuhi Gashi)

OSMANI Veton (1965-). Aktor. Lindi në Prishtinë. Mbaroi studimet për aktrim në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. Aktroi në një sërë shfaqjesh, disa prej të cilave janë: “Emira”, “Vemtrusët”, “Vdekja më vjen prej syve të tillë”, “Bregu i pikëllimt”, “Burri burrë”, “Venedikasja”, “Dredhëza mbi varrë”, “Kur lindi partia”, “Koprraci”, “Ëndrra e qenit”, “Jam talent se jo mahi”, “Ruleti ballkanik”, “Babai”, “Xhaxha Vanja”, “Beselam pse më flijojne”, “Hana prej letre”, “Lisistrata”, “Aleksandër Moisiu”, “Heronjtë e kombit”, “Oda në Hamburg”, “Hamleti”, “Nirvana” etj. Luajti edhe në filmat e metrazhit të gjatë: “Anatema”, “Gomarët e kufirit”. “Vjeshta e trëndafilave”, “Era e mollës”, “Falja e gjakut” etj. Mori pjesë në seriale televizive dhe u shpall aktori më i mirë më 2007 në Festivalin e Teatrove të Dibrës si dhe në Festivalin e filmit “9/11” në vitin 2011. (Selman Jusufi)

OSMANI Zihni (1936-). Albanolog, profesor. Lindi në Kranjë të Pespës. Studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe i kreu në Prishtinë, ku kreu studimet pasuniversitare dhe mbrojti tezën e disertacionit të doktoratës mbi të folmen e Manastirit dhe rrethinës. Punoi si mësime në gjimnazin “Zef Lush Marku” në Shkup dhe më vonë ligjërues dhe profesor i gjuhës shqipe në Akademinë Pedagogjike në Shkup (1975-1981). Po atë vit u zgjodh ligjërues në katedrën e gjuhës dhe të letërsisë shqipe në Shkup, por u largua nga puna për pasojë të diferencimit ideopolitik. Në periudhën 1984-1994 punoi si përkthyes nga gjuha serbokroate në gjuhën shqipe dhe anasjelltas në Elektroekonominë e Kosovës dhe prej 1994 deri më 2001 në Fakultetin e Filologjisë në Shkup, si profesor i gjuhës së sotme shqipe (sintaksës). U mor me hartimin e teksteve shkollore në bashkautorësi. Mori pjesë në simpoziume e konferenca, botoi artikuj profesionalë e shkencorë dhe monografitë: “E folmja shqipe e Pespës”, “E folmja shqipe e Manastirit dhe e qarkut të tij”, “Prespa dhe zhvillimi i arsimit në gjuhën shqipe”, si dhe

fjalorët në bashkautorësi: shqip-maqedonisht e maqedonisht-shqip dhe Maqedonisht-shqip prej 42,000 fjalësh. (Berton Sulejmani)

OSMANI-MULLIQI Gjyle (1954-). Mjeke, mikrobiologe, profesore universiteti. Lindi në Raushiq të Pejës, shkollimin e kreu në Pejë, studimet në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë (1978). Punoi në Pejë në Entin Higjienik-Epidemiologjik (1978-1983), ndërsa specializimin e nga mikrobiologjia humane e përfundoi në Zagreb. Po në Zagreb kreu edhe studimet pasuniversitare, kurse tezën e magistraturës e mbrojti në **Prishtinë**. Në vitin 1983 u emërua asistente, më pas ligjëruese dhe mori titujt e tjerë universitarë për lëndën e mikrobiologjisë. Mbrojti tezën e disertacionit të doktoratës në vitin 2001 në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. U emërua drejtoreshë e departamentit të mikrobiologjisë dhe kreu detyrën e mbikëqyrëses së laboratorëve në Kosovë (2000-2007). Publikoi një sërë punimesh shkencore dhe profesionale, si autore dhe bashkautore dhe mori pjesë në kongrese dhe simpoziume të ndryshme brenda dhe jashtë vendit. Për ngritje profesionale ka qëndruar në vende të ndryshme të Europës dhe në SHBA. Është profesore e rregullt e Fakultetit të Mjekësisë dhe punon në Institutin e Shëndetit Publik të Kosovës. (Tahire Maloku)

OSMANISHTJA. Term lingvistik që nënkupton një formë të gjuhës turke, e cila ishte gjuhë zyrtare dhe letrare e Perandorisë Osmane. Osmanishtja, që nga shek. XIII, kur datojnë tekstet më të hershme nga territori i Anadollisë në këtë gjuhë përdorte alfabetin arab. Nga fillimi i shek. XV e këndej në osmanishte mbizotërojnë elementet e arabishtes dhe të persishtes, si dominante në kulturën islame. Ndikimi i arabishtes dhe i persishtes nuk kufizohej vetëm në leksik, por edhe në morfologji (shumësi dhe gjinia e emrave) dhe sintaksë (fjalitë ndajfoljore, parafjalët, radhitja e elementeve të fjalisë). Vetë termi *osmanisht* ka karakter politik, duke qenë se emëronte dinastinë sunduese. Qasja sistematike ndaj studimit të gjuhës osmane fillon në mesin e shek. XIX, në periudhën e reformave të Tanzimatit. Deri atëherë gjuha osmane-turke nuk ishte as lëndë në medrese, kurse fjalorët dhe gramatikat i hartonin kryesisht të huajt për nevojat personale. Osmanishtja ndahet në tri faza: 1. osmanishtja e vjetër (shek. XIII-XV);

2. osmanishtja e mesme apo klasike (shek. XV-XIX) dhe osmanishtja e re (1839-1908). (Jahja Hundozi)

OSMANOLOGËT BOSHNJAKË PËR KOSOVËN. Osmanologë që studiuin dhe dhanë kontribut për njohjen e periudhës osmane edhe në Kosovë, nga të cilët më të shquarit janë: Hazim Shabanoviq, Hamid Haxhibegiq, Adem Hanxhiq, Eshref Kovaçeviq, Salih Trako etj. Kontributi i tyre mbetet i rëndësishëm veçanërisht për periudhën më të hershme të sundimit osman (shek. XIV-XV). Spikasin edhe botimet e tyre dokumentare për periudhën osmane të historisë së Kosovës: Hazim Shabanoviq, “Regjistër kadastral i përmbledhur i vitit 1455, për rajonin kufitar të Isa Beut, djalit të Is’hak-ut”; Hamid Haxhibegiq, Adem Hanxhiq, Eshref Kovaçeviq, “Regjistër i hollësishëm kadastral i zotërimit/vilajetit të Vuk Brankoviqit”. Këta regjistra kadastralë, të publikuar nga Instituti Oriental në Sarajevë, edhe sot mbeten dy dokumente themelore që hedhin dritë mbi rrethanat ekonomiko-fiskale dhe demografike në territorin e Kosovës, në momentin e parë që ajo kaloi nën sundimin e plotë osman. Si të tillë, regjistrat reflektojnë mjaft mirë situatën paraosmane, por edhe fazën kalimtare drejt vendosjes së sundimit klasik osman. Të dhënat që ofrojnë këta dy regjistra hedhin dritë edhe mbi ngjarjet, fazat nëpër të cilat kaloi ky territor, deri në vendosjen e plotë të sundimit osman dhe për hapat konkretë përmes të cilave u realizua ky proces. Fshatrat, nahijet dhe vilajetet e regjistruara, në mënyrë të detajuar dhe të përmbledhur, ofrojnë një panoramë të plotë të situatës toponimike në këtë rajon. Standardet metodologjike dhe saktësia shkencore në deshifrimin e tekstit osmanisht bëjnë që këta dy regjistra edhe sot të mbeten vepra themelore për fillimet e historisë osmane në Kosovë. (Dritan Egro)

OSOJANI. Fshat i tipit të shpërndarë, 18 km në juglindje të Istogut. Shtrihet në lartësi mbidetare 500 m. Ka sipërfaqe 1,141 ha, shumica pyje, më pak ara dhe livadhe. Popullsia merret me bujqësi ekstensive, kryesisht me lavërtari. Vjetërsia e vendbanimit dëshkohet nga dokumentet e ndryshme mesjetare. Me emrin Otojan, Opojan dhe Osojan është i regjistruar në sallnamet e vilajetit të Kosovës të vitit 1893, 1896 dhe 1900. Vendbanimi është përfshirë

nga valët e shpërnguljes, të cilat rrezikojnë të marrin përmasat e shpopullimit. Në vitin 2011 Osojani kishte 65 banorë, ndaj 279 banorë sa kishte në vitin 1921. Është bashkësi lokale, në të cilën gravitojnë vendbanimet Polana, Shalinovica, Koshi dhe Tuqepi. Ka shkollën 9-vjeçare, stacionin shëndetësor, disa dyqane tregtare etj. (Bajram Kafexholli)

OSTRENI Gëzim (1942-). Veprimtar politik, ushtarak. Lindi në Dibër (Maqedoni). Pas shkollës së mesme në Shkup, kreu Shkollën e Këmbëtorisë për Oficerë Rezervë në Bileqe,



GËZIM OSTRENI

ku mori gradën e nëntogerit të këmbëtorisë. Gjithashtu u diplomua për filozofi-sociologji në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Gjatë viteve ’60 u zgjodh në forume të ndryshme politike të Maqedonisë, ndërsa më 1969 mori detyrën e inspektorit të kufirit në Dibër. Më 1972 u dërgua për kualifikim në Akademinë Ushtarake në Beograd, për t’u përgatitur si oficer shtabi. Ishte komandant i mbrojtjes territoriale të komunës së Dibrës deri në pensionim më 1991, me gradën major. Në fillim të vitit 1999 u përfshi në radhët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), ku mori detyrën e shefit të shtabit të Zonës së Tretë Operative të Dukagjinit. Pas demilitarizimit të UÇK-së u emërua shef i Shtabit të Përgjithshëm të Trupave Mbrojtëse të Kosovës (2000). Me shpërthimin e luftës në Maqedoni (2001) u emërua kryeshf i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare. Më 2002 u zgjodh deputet në Parlamentin e Maqedonisë nga radhët e Bashkimit Demokratik për Integritim. Në vitin 2005 u zgjodh nënkryetar i Kuvendit të Maqedonisë. Ka botuar disa libra, ndër të cilët: “Dëshmia e gjeneralit para Tribunalit të Hagës” (2011), “Ushtria Çlirimtare Kombëtare” (2014) etj. (Fehari Ramadani)

OSTROGORSKI Georg (1902-1976). Historian, bizantinolog, filozof, akademik. Lindi në Peterburg të Ruisë, ku kreu dhe gjimnazin. Bashkë me familjen emigroi në Finlandë. Studioi filozofinë, ndërsa u doktorua në fushën e historisë (bizantologji) në Universitetin e Hajdelbergut në Gjermani. Një kohë ligjëroi



GEORG
OSTROGORSKI

cave dhe të Arteve të Serbisë (1948). Ishte anëtar i rregullt i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Serbisë dhe anëtar korrespondent i disa akademive ndërkombëtare. Opusi shkencor i tij përbëhet nga disa dhjetëra studime, diskutime dhe kritika nga fusha e bizantologjisë. Vepra më e rëndësishme e tij është “Historia e Bizantit”, të cilën e botoi së pari në gjermanisht (1940). Vepra paraqet një sintezë të të gjithë faktorëve që ndikuan në zhvillimin e Bizantit. Rrjedhimisht, ajo është botuar dhe ribotuar në disa gjuhë dhe në të ka të dhëna të rëndësishme edhe për ngjarjet e zhvilluara në trojet mesjetare shqiptare. Vdiq në Beograd. (Qerim Dalipi)

OSHLANI Igballe (1954-1999). Mjeke, dëshmore. Lindi në Vushtrri, ku kreu shkollimin fillor dhe të mesëm. Përfundoi Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë (1984). Punoi në Shtëpinë e Shëndetit në Vushtrri. Në pranverë të vitit 1999, bashkë me familjen, përjetoi deportimet dhe ekzodin. Të dëbuarit nga Mitrovica, ku gjendej edhe I. Oshlani, u detyruan të marrin rrugë në drejtim të Shqipërisë. Një pjesë e kolonës ndalet me dhunë në fshatin Zabllaq. Më 8 maj 1999 ushtria serbe granatoi fshatin Zabllaq dhe popullatën civile. Mjekja I. Oshlani ishte duke u ofruar ndihmë mjekësore civilëve, kur u mor nga ushtria dhe paramilitarët serbë dhe u masakrua bashkë me bashkëshortin dhe një numër civilësh të tjerë. (Ali Llunji)

OSHTIR Karel (Oštir) (1888-1973). Gjuhëtar sloven. Studioi gjuhësinë krahasimtare në Grac dhe në Vjenë (1909–1913). Ishte profesor universiteti në Vjenë dhe në Lubjanë. Më 1953 u zgjodh anëtar i rregullt i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Sllovenisë, por pas pak vitesh jep dorëheqje (1958). K. Oshthir e mbrojti fuqimisht lëvizjen “Fjalët dhe gjërat” (Wörter und Sachen). Fokusi i punës së tij ishte hulumtimi i elementeve paraindoeuropiane i

ndërmjetësuar përmes *shtresave gjuhësore në jug të Europës* (ilirishtja, trakishtja). Në veprat e hershme u mor me gjuhësinë krahasimtare indoeuropiane, veçanërisht me etimologjinë (doktrinën e origjinës dhe kuptimin fillestar të fjalëve) dhe fonetikën. Njihet ndërkombëtarisht si një nga pionierët e teorisë së laringaleve. I hulumtoi gjurmët e lashta gjuhësore, përfshirë iliro-trakase në shqipen. Botoi studime te revista “Arhiv za arbanasku starinu, jeziku i etnologiju”. (Hana Radoniqi)

OTROKËT. Sklevër në shtetin e Rashës (Serbisë). Ishin kategoria më e ulët e popullsisë së varur, por nuk ishin në numër të madh. Kryenin punën e shërbëtorit ose të luftëtarit në oborret e sundimtarëve dhe të feudalëve. Otrokët ishin në pronësi të plotë të zotit të tyre, i cili mund t’i shiste. Ata shpeshherë jetonin bashkë në një fshat me meropsët (fshatarë të varur), duke shlyer bashkërisht detyrimet ndaj të zotit të tyre. Në dokumentet kishtarë hasen si robër që punonin në fushë dhe në vreshtari. Për nga përkatësia etnike, ata ishin rasiano-serbë, arbëror dhe vllëh. Sipas Kodit të Dushanit (shek. XIV) otroku i krishterë nuk mund t’i shitej një personi jo të krishterë. Otrokët nuk mund të dhuroheshin si prikë dhe nuk kishin të drejtë t’i ankoheshin gjyqit perandorak. Lirinë mund ta fitonin me pëlqimin e të zotit të tyre. (Qerim Dalipi)

OXHAKU I DERRALLAJVE TË TETOVËS. Ishte njëra nga familjet e mëdha shqiptare të shek. XVIII-XIX nga Tetova. I pari pinjoll i oxhakut të Derrallajve që mori pozita drejtuese në sanxhaqet shqiptare ishte Rexhep Pasha (vdiq më 1726), me origjinë nga fshati Bicaj i sanxhakut të Prizrenit. Djali i Rexhep Pashës, Hasan Pasha, qe pushtetar i Tetovës, ku në mesin e shek. XVIII ndërtoi Urën e Topit. Pinjulli më i rëndësishëm i oxhakut të Derrallajve ka qenë Rexhep Pashë Plaku (vdiq më 1822). Ai në vitin 1780 mbante pozita drejtuese në Tetovë, ndërsa në vitin 1786 mori edhe qeverisjen e sanxhakut të Shkupit. Rexhep Pashë Plaku lidhi krushqi me familje të fuqishme shqiptare, si me Bushatlinjtë, Mahmudbegollët dhe me Frashërllinjët. Oxhaku i Derrallajve fuqizimin më të lartë politik dhe ekonomik e arriti nga fundi i shek. XVIII e deri në fillim të viteve ‘40 të shek. XIX, kur bijtë e Rexhep Pashë Tetovës, Abdurrahman Pasha, Hivzi Pasha dhe

Hasan Pasha qeverisnin një territor të gjerë dhe të pasur, që përfshinte fushën e Pollogut, Shkupin e deri në Shtip. Pashallarët e oxhakut të Derrallajve morën pjesë aktivisht në lëvizjen kryengritëse të pashallarëve shqiptarë kundër reformave centralizuese osmane të viteve '30 të shek. XIX dhe ruajtën me sukses marrëdhëniet e mira midis myslimanëve dhe të krishterëve në territorin ku qeverisën. Shumica e pinjollëve të Oxhakut të Derrallajve u likuiduan, u internuan dhe u shpronësuan nga sulltani në fillim të viteve '40. I biri i Hasan Pashës, Mehmet Pashë Derralla, i lindur në Gradec të Gostivarit (1843), u shqua për veprimtarinë e tij patriotike jo vetëm në vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, por edhe në vijim, deri në shpalljen e Pavarësisë në Vlorë, si njëri ndër nënshkruesit e Deklaratës së Pavarësisë. Pjesëtarë të oxhakut të Derrallajve kanë lënë ndërtime të rëndësishme, sidomos në Tetovë. Rexhep Pasha gjatë viteve 1785-1820 rinovoi teqenë bektashiane të Harabati Babës dhe e zgjeroi atë me disa objekte përcjellëse, si dhe rinovoi hamamin dhe Xhaminë e Larme, të ndërtuar në vitin 1495 nga dy motrat, zonja Hurshide dhe zonja Measure, si dhe filloi ndërtimin e Kalasë së Tetovës, të cilën e përfundoi i biri, Abdurrahman Pasha. (Nehat Krasniqi)

OXHAKU I GJINOLLËVE. Familje e njohur e periudhës osmane, e cila luajti rol të rëndësishëm në jetën politike, ekonomike dhe kulturore të Gjilanit, të Novobërdës dhe të Prishtinës gjatë shek. XVIII-XIX. I pari i kësaj familjeje ka qenë Ali Pashë Gjini. Në Gjilan ata ndërtuan institucionet e rëndësishme publike, fetare dhe kulturore-arsimore, si Xhaminë e Vjetër, hamamin me ujësjellësin, çarshinë me objektet përcjellëse, kullën e sahatit etj. Nga kjo familje janë ndërtuar objekte të kultit edhe në Prishtinë, ndër të cilat spikat Xhamia e Jashar Pashës. Gjatë periudhës së reformave të viteve 1789-1839 dhe pas shthurjes së sistemit të timarit dhe hyrjes në fuqi të sistemit të çifligut, kjo familje u fuqizua ekonomikisht, i rriti dhe i zgjeroi çifligjet e saj në sanxhakun e Prishtinës. Duke qenë se pjesëtarë të kësaj familjeje kishin fituar grada në rang të beut e të pashait në institucionet përkatëse të administratës osmane, rrjedhimisht fituan postin e mytesarifit-prefektit në Nezaretin e Shkupit me seli në Prishtinë, për të qeverisur

në sanxhakun e Prishtinës. Në Prishtinë kanë ardhur në pushtet nga viti 1758 me Hysrev Beun, të cilin e trashëgoi i biri, Bahtijar Beu. Pas tij për mytesarif vjen i vëllai, Maliq Pasha, dhe së fundmi, nipi i Maliq Pashës, Jashar Pasha, i biri Bahtijar Beut. Familja Gjinolli luajti rol të rëndësishëm në rezistencën ndaj reformave të Tanzimatit dhe më vonë edhe gjatë kohës së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Abdurrahman Pasha ka qenë kryetar i Lidhjes Shqiptare për Prishtinë, ndërsa bijtë e tij, Zija Beu dhe Ali Danish beu, kanë qenë anëtarë aktivë të Komitetit të Stambollit dhe veprimtarë të Lidhjes. Fuad bej Gjinolli ishte deputet i Prishtinës në Parlamentin Osman. (Iljaz Rexha)

OXHAKU I KRYEZINJVE. Njëra nga familjet e mëdha shqiptare të shek. XVII-XIX nga Gjakova. Pinjollët e kësaj dere u fuqizua politikisht dhe ekonomikisht nga gjysma e dytë e shek. XVII. I pari i Kryezinjve, që u ngjiti në hierarkinë politike osmane, ishte Hasan Pashë Gjakova, i cili që nga viti 1649, kur u bë bejlerbej i Bosnjës e deri në vitin 1694, kur në moshë të shtyrë erdhi në pozitën e mytesarifit të Shkodrës, ka qenë vali në vilajete të ndryshme të Perandorisë Osmane, por fuqinë më të madhe ekonomike dhe famën e arriti në Hungari, ku themeloi një kompleks vakëfesh që përbëhet nga një xhami (e cila gjendet edhe sot), një medrese dhe një mevlevihane. Oxhaku i Kryezinjve u faktorizua pas disfatës së ushtrisë osmane para mureve të Vjenës (1683). Nga kjo kohë familja e Kryezinjve, së bashku me familjen e Mahmudbegollëve, të Bushatlinjve, të Vlorajve etj. u bënë faktorë më të rëndësishëm politikë dhe ushtarakë në hapësirat shqiptare. Nga viti 1703, oxhaku i Kryezinjve, sikundër edhe oxhaqet e tjera shqiptare, fituan të drejtën e trashëgimit familjar të gradave dhe të pozitave drejtuese në sanxhaqet shqiptare. Pas përfundimit të luftërave austro-osmane dhe veneto-osmane në fund të dekadës së tretë të shek. XVIII, oxhaku i Kryezinjve dhe oxhaqet e tjera shqiptare qeverisnin pothuaj gjysmë të pavarur nga Porta e Lartë, duke manifestuar herë-herë një rivalitet ndërmjet tyre, që shkonte deri në gjakderdhje. Pinjollët e oxhakut të Kryezinjve, si: Kurt Mehmet pasha, i biri i Hasan Pashë Gjakovës, Mahmud Pasha, i biri i Hasan Pashë Gjakovës dhe tetëmbëdhjetë pasardhës të tjerë të Kurt Pashë Gjakovës kanë fituar gradën

Pasha dhe kanë luajtur rol të rëndësishëm në jetën politike ekonomike dhe kulturore jo vetëm të Gjakovës, të sanxhakut të Dukagjinit, të sanxhakut të Prizrenit, të sanxhakut të Shkodrës, por edhe më gjerë, në sanxhaqet shqiptare të Shqipërisë së Veriut, deri në fund të periudhës osmane. (Nehat Krasniqi)

OXHAKU I MAHMUDBEGOLLËVE. Njëra nga familjet e mëdha shqiptare të shek. XVI-XIX nga Peja. Pinjollët e kësaj dere u fuqizuan politikisht dhe ekonomikisht qysh në fillimet e pushtetit osman. I pari i kësaj dere, i cili u shqua si pushtetar osman, ishte Feriz Pasha, vali në gjysmën e dytë të shek. XV. Deri në gjysmën e dytë të shek. XVII, pinjollët e kësaj dere njiheshin me mbiemrin Bolla-zade ose Bollica. Pas daljes në skenë politike të Mahmud Pashës nga fundi i shek. XVII, kjo familje mori mbiemrin Mahmudbegolli. Nga pasardhësit e Mahmud Pashë Mahmudbegollit dhe të vëllait Hydaverdi Pasha kanë dalë më shumë se 20 pashallarë, sanxhakbejerë dhe pushtetarë e komandantë ushtarakë, të cilët kanë qeverisur në sanxhakun e Dukagjinit, të Prizrenit, të Shkodrës, të Elbasanit dhe në sanxhaqe të tjera, përfshirë atë të Janinës. Kulmin e fuqisë politike dhe ekonomike oxhaku i Mahmudbegollëve e arritën gjatë dy dekadave të fundit të shek. XVII dhe gjysmës së parë të shek. XVIII. Oxhaku i Mahmudbegollëve kishte lidhje martesore me Vlorajt, Bushatlinjtë, Gjinollajt, Derallajt dhe sidomos me Kryezinjët e Gjakovës. Pinjollë të oxhakut të Mahmutbegollëve morën pjesë aktivisht në të gjitha organizimet dhe ngjarjet e rëndësishme politike dhe ushtarake shqiptare në Kosovë dhe më gjerë që nga fundi i shek. XVII e deri në fund të pushtetit osman. Pinjollët e këtij oxhaku morën pjesë në përpjekjet për autonomi të Bushatlinjve të Shkodrës, ku u shquan vjehrrit i Kara Mahmud Pashë Bushatit, Ibrahim Pashë Mahmudbegolli, me të birin Kahreman Pashën, të vrarë në vitin 1788; në lëvizjen kryengritëse të pashallarëve shqiptarë kundër reformave centralizuese të pushtetit osman të viteve '30 të shek. XIX u shquan haxhi Hasan Arslan Pasha (vdiq më 1843); në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit u shquan Halil Pasha dhe Shaban Pasha; në Lidhjen Shqiptare të Pejës u shquan Halil Pasha dhe Zejnel Beu; si dhe në Kuvendin Kombëtar të Vlorës më 1912 u shquan Zejnel Beu dhe Qerim Beu. (Nehat Krasniqi)

OXHAKU I RROTLLAJVE. Njëra nga familjet e mëdha shqiptare të shek. XVIII-XIX nga Prizreni. Të parët e oxhakut të Rrotllajve ishin me prejardhje nga fshati Nangë i Lumës. I pari i kësaj familjeje ishte Salih Zaimi, i cili kishte fituar një ziamet në Prizren, ku dhe ishte vendosur familjarisht. Salih Zaimi la dy djem: Mahmudin dhe Mehmedin, të cilët nuk kanë pasur ndonjë pozitë në Prizren, por nipi i tij, Salih Pasha, i biri i Mahmudit, në vitin 1747 fitoi gradën Pashë dhe u emërua sanxhakbej i Prizrenit. Këtë pozitë e mbajti deri në vitin 1749. Pas tij postin e sanxhakbeut të Prizrenit e kishin bijtë e tij, Emrullah Pasha (që vrarë nga pashai i Shkodrës më 1774) dhe Ismail Pasha (sanxhakbej i Prizrenit në vitin 1785). Këtë pozitë më pastaj e patën fituar të bijtë e Emrullah Pashës, Tahir Pasha (1794) dhe Rustem Pasha (1800). Më vonë këtë pozitë e arritën bijtë e Tahir Pashës, Said Pasha (1805-1815), Mahmud Pasha (1819-1836) dhe Emin Pasha, i cili qe emëruar për të dytën herë sanxhakbej i Prizrenit në vitin 1842 (vdiq më 1843). Oxhaku i Rrotllajve gjatë qeverisjes mbi një shekull dha kontribut të rëndësishëm në jetën politike, ekonomike, sociale dhe kulturore të sanxhakut të Prizreni dhe më gjerë. Pinjollit i këtij oxhaku, Salih Pasha punoi shumë për rindërtimin dhe rigjallërimin e Prizrenit të rrënuar nga forcat austriake (1689-1690). Në gjysmën e dytë të shek. XVIII, pashallarë të oxhakut të Rrotllajve kishin punësuar një numër të konsiderueshëm ndërtimtarësh arumunë nga jugu i Shqipërisë, të cilët u vendosën me familjet e tyre në bregun lindor të varoshit, mbi qytetin e Prizrenit. Me përkrahjen e oxhakut të Rrotllajve, në gjysmën e dytë të shek. XVIII në Prizren nisi përparimi i zanateve dhe i tregtisë, sidomos zanati i dyfekçinjve. Pushkët e prodhuara në mbi 100 dyqane në Prizren në gjysmën e parë të shek. XIX shkonin edhe në tregjet e Azisë së Vogël, të Egjiptit dhe të Indisë. Pinjollë të oxhakut të Rrotllajve rezistuan me armë kundër reformave të sulltan Mahmutit II (1808-1839), për çka u dallua Mahmud Pasha, i cili u ekzekutua nga sulltani. Nga ky oxhak kanë dalë donatorë objektesh e institucionesh të ndryshme arsimore, kulturore, fetare, sociale etj. Said Pasha në vitin 1805 ndërtoi bibliotekën e parë publike në Prizren, ndërsa vëllezërit e tij, Mahmud Pasha dhe Emin Pasha ndërtuan dy medrese, tri kulla sahati (Prizren, Rahovec, Mamushë), katër xhami, si dhe e rinovuan hamamin e Mehmet Pashës. (Nehat Krasniqi)

OZNA. Shkurtesë e emërtimit serbisht të shërbimit sekret jugosllav (Odeljenje za zaštitu naroda - Seksioni për Mbrojtjen e Popullit), i cili u formua nga strukturat udhëheqëse të Partisë Komuniste dhe Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Jugosllavisë (LNÇJ). Qëllimi këtij shërbimi ishte mbrojtja e lëvizjes nga veprimtaria dhe propaganda e armikut, duke grumbulluar të dhëna për forcat, synimet, spiunët, diversantët etj. dhe për ruajtjen e organeve drejtuese të “pushtetit popullor” në territoret e çliruara. Bartës kryesorë të kësaj veprimtarie ishin shërbimet e zbulimit dhe të kundërzbulimit, pastaj të ashtuquajturat “roja partizane”, “milicia popullore” etj. Informata zyrtare për themelimin e OZN-ës u dha më 27 nëntor 1942 nga komandanti suprem i Ushtrisë Nacionalçlirimtare dhe Aradheve Partizane të Jugosllavisë. Më pas shërbimi u specializua për ndjekjen e kundërshtarëve dhe armiqve të brendshëm në radhët PKJ-së, të Frontit Popullor dhe në komandat e njësiteve të armatosura të të gjitha niveleve. Pas Luftës së Dytë Botërore, OZN-a vazhdoi të ruajë interesat e LNÇJ-së në bashkëpunim me Milicinë Popullore dhe Korpusin e Mbrojtjes

së Popullit. Në fillim të vitit 1946, në vend të saj u formua Sigurimi i Brendshëm Shtetëror (UDB-a, Unutrašnja državna bezbednost). Që nga formimi e deri në shuarjen e tyre, këto dy shërbime dhe organet e tyre u bënë sinonim i dhunës dhe terrorit që ushtruan ndaj shqiptarëve të Kosovës dhe të shqiptarëve në ish-Jugosllavi në përgjithësi. (Izber Hoti)

OZRIMI. Fshat i tipit të zgjatur, 10 km në verilindje të qytetit të Pejës. Shtrihet në bregun e djathtë të Drinit të Bardhë, në lartësi mbidetare 455 m. Është vendbanim fushor, me sipërfaqe 230,6 ha. Rreth 90% e sipërfaqes janë me ara, kurse pjesën tjetër e zënë livadhet. Popullsia merret me bujqësi. Si vendbanim me 13 shtëpi përmendet në regjistrin kadastral osman të Sanxhakut të Shkodrës të vitit 1485. Me emrin Ozdrim, Ozrin shënohet në hartat e shekullit XVI (Gastaldi, 1546). Në një hartë osmane të fundit të shek. XIX është i regjistruar me emrin Ozuirem. Në vitin 2011 Ozrimi kishte 426 banorë, ndaj 120 banorë në vitin 1921. Ka shkollën 9-vjeçare, stacionin shëndetësor dhe disa njësi tregtare. (Bajram Kafexholli)

P

PACOLLI Behxhet (1951-). Politikan, afarist. Lindi në Marec, komuna e Prishtinës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa të mesmen në Prishtinë. Nga viti 1974 drejtoi kompani të



BEHXHET PACOLLI

ndryshme në Kosovë, në Austri dhe në Zvicër, ndër të cilat edhe “Mabetex Project Engineering”, me seli në Lugano (Zvicër), të themeluar në vitin 1990 nga disa shoqëri shumëkombëshe. Nën drejtimin e tij kompania u bë e njohur për rindërtimin e kompleksit qeveritar të Kremlinit në Moskë. Më pastaj, për një kohë u mor me punë ndërtimore në qytete të ndryshme të Rusisë, të Kazakistanit etj. Në vitin 2004 në Prishtinë themeloi Aleancën “Kosova e Re”, e cila në vitin 2007 u shndërrua në parti. Në vitin 2011 u zgjodh president i Republikës së Kosovës, por dha dorëheqje për shkak se Gjykata Kushtetuese e quajti të parregullt zgjedhjen e tij. Në periudhën 2011-2014 partia e tij hyri në koalicion me Partinë Demokratike të Kosovës (PDK) dhe B. Pacolli mori postin e zëvendëskryeministrit. Në zgjedhjet e vitit 2014 partia e tij nuk kaloi pragun zgjedhor. Është themelues i Lëvizjes për Unionin Ekonomik Shqiptar (2012). Ishte aktiv në lobimin për njohjen e pavarësisë së Kosovës. (Nerxhivane G. Dauti)

PAÇARADA Shukri (1967-). Futbollist, trajner i futbollit. Lindi në Podujevë. Karrierën e filloi me “Llapin” e Podujevës, duke i kaluar të gjitha grupmoshat. Si portier i talentuar kaloi në radhët e “Prishtinës”, në kohën kur kjo skuadër bënte gara në Ligën e parë të ish-Jugosllavisë. Në moshën 20-vjeçare, në

vitin 1987 debutoi në ndeshjen me njërën prej skuadrave më të mira të ish-Jugosllavisë, “Cërvena Zvezdën” e Beogradit, ndeshje që pati përfunduar me rezultat 3:1 për Prishtinën. Pas rrethanave të krijuara në Kosovë, Paçarada e vazhdoi karrierën në Gjermani në skuadrën “Alemania Achen”, ndërsa përfundoi futbollin aktiv në FC “Oberneuland”. Sh. Paçarada i takon “brezit të artë” të KF “Prishtina”. Është trajner i portierëve në skuadrën e njohur gjermane “Bajer Leverkuzen”. (Bekim Aliu)

PAÇARIZI Haxhi Ymer Lufti (1870-1928). Poet, sheh, veprimtar politik. Lindi në Prizren në një familje me prejardhje nga Malësia e Dibrës. Pas mbarimit të shkollës fillore (mejtepit) dhe Gjimnazit të ulët (Rushdijes) më 1887, u regjistrua në Medresenë e Fatihut në Stamboll, ku qëndroi deri më 1901. Pas Stambollit shkoi në Kajro dhe u regjistrua në Universitetin “Al-Azhar”, ku studioi katër vjet gjuhën arabe. Më 1905 u kthye në Prizren. Pas fitores së Turqve të Rinj gëzoi autoritet të madh dhe besimin e qeveritarëve të atëhershëm. Mirëpo, u dëshpërua shpejt. Ishte anëtar i organizatës “Xhemijeti” dhe veprimtar për të drejtat e shqiptarëve në Mbretërinë Serbe-Kroate-Slllovene. Ka shkruar mbi 60 vepra në prozë dhe poezi në gjuhën arabe, turke dhe persiane. Ka botuar shkrime, sidomos poezi, nga të cilat shihet qartë angazhimi i tij për të drejtat e shqiptarëve, të cilat i ka botuar në shtypin e kohës. Është autor edhe i një divani. Veprat e haxhi Ymer Lufti Paçarizit u përkasin fushave të ndryshme, si: filozofike, fetare-mistike, politike, didaktike-pedagogjike dhe lirike, në stilin e poezisë së divanit. (Nehat Krasniqi, Sadik Mehmeti)

PAÇARIZI Nuhi (1969-). Lindi në Dragobil të Malishevës. Shkollën fillore e kreu në

vendlindje, të mesmen në Malishevë dhe Rahovec. Kreu studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës. Që në kohën e studimeve bashkëpunoi me gazetën e studentëve “Bota e re” (1990-1999) dhe me gazetën e përditshme “Bujku” (“Rilindja” në Perëndim), si dhe me revistën “Zëri”. Në periudhën 1994-1999 punoi korrespondent i gazetës “Zëri i Kosovës” që dilte në Zvicër. Nga themelimi u angazhua si gazetar i agjencisë së lajmeve “Kosovapress” (janar 1999) dhe bashkëpunëtor i Radios “Kosova e lirë”, ndërsa pas përfundimit të luftës edhe redaktor dhe kryeredaktor i agjencisë “Kosovapress”. Nga viti 2000 deri më 2002 ishte kryeredaktor i gazetës “Zëri i Kosovës”, botimi në Kosovë dhe në vitet 2010-2011 redaktor në gazetën e përditshme “Lajm”, edicioni online. (Rrahman Paçarizi)

PAÇARIZI Rrahman (1972-). Gjuhëtar, publicist, profesor universiteti. Lindi në Malishevë, ku përfundoi shkollimin fillor, ndërsa shkollën e mesme e kreu në Rahovec. U diploma



RRAHMAN
PAÇARIZI

mua për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës (1994), ku kreu studimet pasuniversitare dhe mbrojti tezën e disertacionit të doktoratës (2006). Nga viti 1996 punon në departamentet e gjuhës shqipe dhe më vonë të gazetarisë. Është profesor i asociuar (2103). Interesimet e tij studimore lidhen me sociolinguistikën, psikolinguistikën, morfologjinë si dhe probleme të terminologjisë gjuhësore. Përveç artikujve studimorë botoi monografitë “Shqipja standarde në parametrat psikolinguistikë” (2011), “Konversioni në gjuhën shqipe” (2015) dhe një fjalor terminologjie të psikolinguistikës (2012). Artikujt e tij lidhen me raportet dialekt-standard, politikën gjuhësore, shqipja në epokën e globalizimit, ideologjitë gjuhësore, terminologjia gjuhësore në këndvështrimin socio-konjitiv, gjuhën e mesenxherit etj. Botoi një libër me poezi. Ishte gazetar i Radios “Evropa e lirë” në periudhën 1998–2007. Është anëtar i Këshillit Ndërkademiq për Gjuhën Shqipe dhe drejtor i Seminarit Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare. (Imri Badallaj)

PAÇUKU Bashkim (1955-). Tenor. Vjen nga qyteti i Dibrës. Kreu studimet në Fakultetin e Muzikës në Shkup. Pas studimeve realizoi dy vizita studimore në Teatrin e Operës e të Baletit në Tiranë dhe në “La Scala” të Milanos (Itali). Ndërkaq, studimet për solokëndim i kreu edhe në Universitetin e Bostonit në SHBA. Një kohë ka punuar si udhëheqës i Korit të Radiotelevizionit të Prishtinës. Si këngëtar-tenor ka marrë pjesë në koncerte të ndryshme dhe ka interpretuar vepra gjinësh të ndryshme të kompozitorëve vendorë e të huaj në Kosovë, Shqipëri, Maqedoni, Kroaci, Itali, Zvicër, Austri, Rusi, Amerikë etj. Repertori i tij përfshin veprat operistike: “La Traviata” (Alfredo), “L’Elisir d’Amore” (Nemorino), “Rigoletto” (Duca), “La Boheme” (Rodolfo), “Die Zauberflote” (Tamino), “Toska” (Cavaradossi), “Faust” (Faust), “Eugene Onegin” (Lenski) dhe pjesë të tjera nga Schubert, Shumann, Donizetti, Bellini etj. Ka marrë pjesë në gara e konkurse dhe është shpërblyer me çmime kombëtare e ndërkombëtare. Jeton dhe vepron në SHBA. (Kristina Palokaj-Perkola)

PAGA. Përfaqëson çmimin e punës për njësi të punës (për orë, ditë, javë apo muaj). Paga nominale është shuma që merr punëtori për njësi të punës, e shprehur në valutën përkatëse të vendit. Ndërkaq, paga reale përfaqëson raportin e pagës nominale ndaj një matësi të nivelit të çmimeve, duke dhënë kështu një vlerësim për fuqinë blerëse të pagës. Paga është rezultat i interveksionit në tregun e punës ndërmjet ofertës dhe kërkesës për punë, duke u ndikuar gjithashtu edhe nga ekzistenca dhe fuqia e sindikatave në treg, si dhe forcat e tjera të tregut të punës. Oferta e punës paraqet numrin e punëtorëve që do të merrnin pjesë në tregun e punës për secilin nivel page. Ndërkaq, kërkesa e punës paraqet numrin e punëtorëve që firmat do të merrnin në punë për secilin nivel page. Pikëprerja e ofertës dhe e kërkesës për punë rezulton me ekuilibrin e tregut të punës, ku përcaktohen paga mesatare dhe niveli i punësimit. Sipas të dhënave të fundit për vitin 2014, rreth 70 për qind të të punësuarve në Kosovë marrin paga neto prej 215 deri në 500 euro për muaj. Paga mesatare neto është rreth 350 euro dhe është mesatarisht më e lartë për meshkuj se për femra. (Avdullah Hoti)

PAGARUSHA Abdylkadër (1946-). Piktur. Lindi në Prizren. Kreu shkollën fillore në

Prishtinë, ndërsa Shkollën e Mesme të Artit në Pejë. Mbaroi Shkollën e Lartë Pedagogjike, degën e artit figurativ në Prishtinë, ndërsa Akademinë Mbretërore të Arteve të Bukura, drejtimin e pikturës, e kreu në Bruksel (1971). Pas studimeve punoi disa vjet si redaktor teknik në Redaksinë e Botimeve “Rilindja” në Prishtinë. Në vitin 1974 u vendos në Bruksel dhe vijoi të merret me pikturë. Mori pjesë në ekspozita të përbashkëta me artistë belgë. Në Anvers të Belgjikës mbaroi studimet pasuniversitare në Institutin e Lartë Kombëtar të Arteve të Bukura (1988). Veprat e tij u ekspozuan në Saint Josse (1975), Vavre (1983), Anvers (1985), Bruksel (disa herë), Pragë (2004) dhe Prishtinë (2010). Me ngjyra të kaltra, gri e nuancime të bardha pasqyroj në tablotë e tij figurën e njeriut në përpjekje ekzistenciale dhe figurën e shpëndit si kujtesë e pasuri e natyrës. Mori disa çmime profesionale në Belgjikë. Jeton e vepron në Bruksel. (Rexhep Goçi)

PAGARUSHA Nexhmije (1933). Këngëtare. Lindi në Pagarushë të Malishevës. Shkollën fillore e kreu në Malishevë, më vonë u vendos në Prishtinë. Shkollimin e mesëm muzikor,



NEXHMIJE
PAGARUSHA

solokëndimin, e filloi në Beograd, ku qëndroi për tri vjet, por për shkak rrethanash jo të volitshme e ndërpreu. Filloi të këndoje që në fëmijëri, por karrierën e vërtetë e nisi më 1948, si këngëtare e Radio Prishtinës. Ishte dhe mbetet primadonë e muzikës popullore dhe asaj zbavitëse. Ka kënduar në manifestime dhe festivale në Kosovë dhe në të gjitha viset e tjera, duke arritur popullaritet të madh për potencialin e saj vokale në ish-Jugosllavi, në Bullgari, Turqi, në disa shtete europiane, si dhe të Lindjes së Afërt, në Amerikë etj. N. Pagarusha posedon një ambitus të gjerë interpretues me elemente kolorature pa vibrime orientale. Këndoi mbi 40 vjet pa ndërprerë dhe jo gjithnjë në kushte të përshtatshme për një soliste si ajo. Repertori i saj interpretues është tejet i gjerë dhe i larmishëm. Veçohen këngët “Ani mori nuse”, “Kur më del në derë”, “Metelikun ta kam falë”, “Po të pres te dega e fikut”, “Mora testinë”, “Kënga e Rexhës” etj. Me saktësi e bukuri i këndoi këngët

e përpunuara dhe të kompozuar nga bashkëshorti i saj, kompozitori Rexho Mulliqi, ndër të cilat: “Lulëzoi fusha, lulëzoi mali”, “Zambaku i bardhë”, “Një lule që m’ka çelë tash”, si dhe ato origjinale: “Baresha”, e cilësuar si xhevahir kolorature, që ruan elementin folklorik të këngës. N. Pagarusha ka ushtruar dhe aktivitet prej aktoreje, duke u paraqitur në disa vepra skenike e filma (“Tre vetë kapërcejnë malin”, “E kafshoja terrin”, “Fluturimi i Micakut”). Vlerësimi i lartë dhe dashuria e madhe që kishin kritikët dhe publiku ndaj saj, bëri që ajo të gëzonte titujt “Bilbili i Kosovës”. Nga viti 1984 vendos të përmbyllë karrierën prej këngëtareje dhe këtë ngjarje e shënoi me një koncert të madh në Sarajevë. Ishte këshilltare në produksionin muzikor të Radio Prishtinës. Më 2012 u dekorua me “Nderi i kombit” nga presidenti i Shqipërisë. (Rreze Kryeziu-Breznica)

PAJA. Lidhet me doket shoqërore dhe është e ndërtuar mbi baza të raporteve të veçanta që nxisin efekte dhe karakter ekonomike në jetën e vajzës dhe në familjen e burrit. Në Kosovë, si edhe krahinat e tjera shqiptare, veçohen zakone që pajën e bëjnë element të veçantë të statusit të gruas në familje dhe shoqëri. Para martesës, me qëllim të sigurimit të lehtësimit të pozitës ekonomike dhe pamjes së saj në ambientin e ri, vajza, sipas mundësive dhe zakonisht, merrte me vete një pasuri të konsiderueshme të mirash materiale, kryesisht të luajtshme: veshmbathje personale, veshmbathje për burrin, shtrojë e mbulojë, por edhe gjësende të dedikuara si dhurata për familjarët e burrit. Mbi këtë “pasuri”, vajzës, përkatësisht gruas, i njihej e drejta e pronësisë edhe pas martesës, gjë që kishte domethënie të veçantë në jetesën e saj, por edhe në kontekstin e kulturës shqiptare. Për nga karakteri i punës, në pajën e vajzës zënë vend punesat - prodhimet e veçanta (shtrojë, petka, zhguna); thurjet me grep ose me shtiza (çorapë, meste, mëngë); qëndisjet me fije natyrash të ndryshme (përdorëse për fjetje, për interier); punëdoret e imëta me grep e me gjilpërë (dantelet, ojnata, aksesoret të ndryshme etj.). Paja në kohën e sotme ka ndryshuar fizionominë e vet dhe e ka humbur kuptimin fillestar.

Prika, ndërkaq, lidhet me zakonisht, sipas të cilit me rastin e martesës, familja e vajzës i jep dhëndrit ose familjes së tij (pronë të paluajtshme, si tokë, shtëpi, ose vlerë në para).

Ky zakon ka pasur shtrirje në shumicën e kulturave europiane, sidomos në kohën e feudalizmit dhe më vonë, ndërsa buron nga zakonet origjinale që lidhen me Romën e vjetër. Prikën e jep vetëm familja e vajzës, por burri nuk mund ta administrojë këtë pasuri, që ndryshe njihet edhe me emërtimin “miras”. Prika i siguronte gruas pavarësi ekonomike në familjen e burrit. Në aspektin juridik, prika konsiderohet si pjesë e pasurisë së familjes së vajzës-nuse, përkatësisht e gruas së martuar. Në rast të prishjes së martesës (divorcit), burri në asnjë mënyrë nuk gëzonte asnjë të drejtë mbi këtë pasuri. Kjo e drejtë, që mbështetej në të drejtën zakonore shqiptare, respektohej edhe në Kosovë. (Drita Halimi-Statovci)

PAJAZITI Agron (1958-). Inxhinier i makinerisë, profesor universitar. Lindi në Pejë, ku kreu shkollën fillore, ndërsa gjimnazin e kreu në Prishtinë. Kreu studimet në Fakultetin e Makinerisë të Universitetit të Prishtinës (UP), ndërsa studimet pasuniversitare i kreu në Fakultetin e Makinerisë dhe të Anijendërimit të Universitetit të Zagrebit. Doktoroi në Fakultetin e Makinerisë të UP-së (1992). Pas diplomimit filloi punën në minierat me flotacion në Kishnicë dhe Novobërdë, ndërkaq nga viti 1981 punon në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike të UP-së, ku ligjëron lëndët: mekanika, sistemet hidraulike dhe pneumatike, rregullimi i pajisjeve procesore etj. Është autor i teksteve universitare dhe i dispensave. Botoi një sërë punimesh shkencore dhe profesionale dhe mori pjesë në konferenca shkencore brenda dhe jashtë vendit. (Xhevat Perjuci)

PAJAZITI Arbnor (1961-). Inxhinier i makinerisë, profesor universiteti. Lindi në Pejë, shkollën fillore, të mesmen dhe Fakultetin Teknik i kreu në Prishtinë. Studimet pasuni-



ARB NOR PAJAZITI

versitare i kreu në Fakultetin e Makinerisë dhe të Anijendërimit të Universitetit të Zagrebit, ndërsa u doktorua në Fakultetin e Makinerisë të Universitetit Teknik të Vjenës (1998). Punoi në Korporatën Elektroenergetike të Kosovës (1984), kurse më pas në Fakultetin e Makinerisë të Universitetit të Prishtinës (UP).

Në vitin 1984 u zgjodh asistent, ndërsa në vitin 2010 merr titullin profesor i rregullt. Ka ushtruar disa funksione drejtuese në institucionet e arsimit të lartë, përfshirë edhe detyrën e rektorit të Universitetit të Prishtinës. (2014). Është autor i disa teksteve universitare (“Bazat e robotikës”, “Robotika në Kosovë” etj.) dhe ka botuar një sërë punimesh shkencore. Ka bërë vizita studimore në Austri, Itali, Gjermani dhe SHBA. Është hartues dhe pjesëmarrës i projekteve të ndryshme. Merret me projektimin dhe konstruktimin e robotëve për operacionet emergjente dhe të dominimit dhe ka konstruktuar platforma të ndryshme robotike. (Xhevat Perjuci)

PAJAZITI Naser (1970-). Gjuhëtar, profesor. Lindi në Radobravë të Prizrenit. Studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe i mbaroi në Fakultetin e Filologjisë në Prishtinë, ku kreu edhe studimet pasuniversitare dhe më pas u doktorua me temë mbi të folmen e Anadrinit (2005). Punoi në Institutin Albanologjik (1996-2008), ku arriti gradën këshilltar shkencor. Aktualisht është mësimdhënës në Fakultetin e Edukimit të Universitetit të Prishtinës. Mori pjesë në konferenca shkencore dhe botoi punime në fushën e gjuhësisë, monografi dhe botime të tjera: “E folmja e Opojës” (2005), “E folmja e Anadrinit” (2008) etj. Ka ushtruar detyra dhe funksione të ndryshme në institucionet e arsimit të lartë. (Pranvera Osmani)

PAJAZITI Zahir (1962-1997). Njëri nga themeluesit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Hero i Kosovës. Lindi në fshatin Turuqicë të komunës së Podujevës. Kreu shkollimin fillor dhe të mesëm në Orllan, pastaj u regjistrua në shkollën e policisë në Vushtrri, por u përjashtua pas një viti si i papërshtatshëm politikisht. Më 1981 u regjistrua në degën e gjuhës dhe letërsisë angleze në Fakultetin e Filologjisë të



ZAHIR PAJAZITI

Universitetit të Prishtinës. Po atë vit mori pjesë në demonstratat në Podujevë. Më pas vazhdoi veprimtarinë ilegale. Në fillim të viteve '90 ishte aktiv në organizimin e Parlamenti Rinor, duke formuar degën e këtij subjekti në Orllan. Ishte aktiv edhe në aksionin e pajtimit të gjaqeve.

Në vitin 1991 Z. Pajaziti shkoi në Shqipëri për stërvitje ushtarake. Kontribuoi në furnizimin me armatim të celulave ushtarake të krijuara në rrethinën e Orllanit. Kaloi shumë herë kufirin e Shqipërisë, gjatë viteve 1994-1997. Gjatë këtyre viteve punoi në zgjerimin e bashkëpunëtorëve të rinj brenda dhe jashtë zonës së Llapit. Në vitin 1996 kreu shumë aksione luftarake të koordinuara në tërë territorin e Kosovës. Disa ditë pas kthimit nga Shqipëria, më 31 janar 1997, së bashku me Hakif Zejnullahun dhe Edmond Hoxhën, Z. Pajaziti u vra në Pestovë afër Vushtrrisë, në një pritë të organizuar nga policia serbe. Më 31 janar 2008, në 11-vjetorin e rënies, presidenti i Kosovës i akordoi urdhrin "Hero i Kosovës". (Ismet Cakiqi)

PALAJ Atë Luigj (1878-1913). Titullar i Kishës Katolike, martir. Lindi në Janjevë. Më 1896 u përfshi në radhët e françeskanëve, ndërsa më 1903 në Zym të Hasit u shugurua meshtar. Gjatë viteve 1905-1907 shërbeu famullitar në Argjipeshkvinë e Shkodrës, më pas kaloi në Gjakovë, por shërbeu edhe në Famullinë e Pejës dhe të Glllogjanit. Në mars të vitit 1913, bashkë me shumë të tjerë, u arrestua nga malazeztë. Pasi u keqtrajtua në burgun e Gjakovës, gjatë rrugës, në Janosh të Novosellës së Gjakovës e ndanë nga grupi, ia zhveshën zhgunin e fratit dhe e detyruan të ecte z bathur. Ia prenë edhe dy gishtërinjtë e dorës së djathtë, që të mos mund të kryqohej si besimtar katolik, por vetëm me tre, siç bëjnë besimtarët ortodoksë. Më pas e masakruan me bajoneta. Fillimisht u varros në Janosh, kurse më vonë u bart në Shëngjergj afër Zymit të Hasit. Në shenjë nderimi për atë Luigj Palajn, ipeshkëvia e Kosovës në vitin 2011 ngriti në Janosh kishën kushtuar këtij martiri, ndërsa presidentja e Kosovës, Atifete Jahjaga, e dekoroi me Urdhrin e Lirisë. (Frrok Kristaj)

PALEOZOIKU. Erëe dytë e historisë gjeologjike të Tokës, që vijon pas parakembrianit e deri në mesozoik, që ka zgjatur 290 milionë vjet, gjatë së cilës janë formuar shkëmbinjtë që përbëjnë eratemian paleozoik. Ndahet në periudhat: kembrian, ordovikian, silurian, devonian, karbonifer dhe permian. Në paleozoik kishte një vendosje të kontinenteve dhe deteve shumë të ndryshëm nga ajo e sotmja, me tokat e mëdha (mega kontinentet) të Laurazisë, në hemisferën veriore dhe atë të Gondvanës, në hemisferën jugore. Gjatë paleozoikut kanë ndodhur dy

malformime të mëdha, kaledoniane dhe ajo herciniane. Kjo e fundit përfshin edhe sektorë të trevës mesdhetare e të Albanidëve. Në erën paleozoike bota organike ka qenë shumë e larmishme. Më të rëndësishëm ishin trilobitet, graptolitet dhe, në paleozoikun e sipërm, bimët e larta me spore dhe fierna, nga të cilat janë krijuar qymyret në karbonifer. Në mbarim të paleozoikut u zhduk pothuajse gjysma e klasave të organizmave që jetuan gjatë kësaj ere. Në Kosovë formacionet paleozoike paraqiten kryesisht në zonën tektonike të Kamenicës (Serbi-Kosovë-Maqenoni) dhe në zonën tektonike të Sharrit. Kanë përfaqësim litologjik dhe gradë metamorfizmi të ndryshme. Krijimet e paleozoikut në Kosovë, në aspektin tektonik, janë modeluar nga orogjeneza hercenike dhe rimodeluar më vonë nga ajo alpike. (Gani Maliqi)

PALI (Paulus Iustinianae). Kryepeshkop dardan në Justiniana Secunda. Ishte pjesëmarrës në Koncilin e Dytë të Konstandinopojës të vitit 553, ku është nënshkruar me titullin që prezentonte qytetin e mëhershëm: Episkopus Ulpianensis (kryepeshkop i Ulpianës). Sipas njoftimeve të Prokopit, Pali luajti rol të rëndësishëm rreth mospajtimit religjioz që ndodhën gjatë sundimit të perandorit Justinian, të njohura si Tre Kapituj (Tria Capitula). Epiqendra e këtij konflikti duket se ishte pikërisht Ipeshkvia e Justinanës së Dytë, të cilën e udhëhiqte ipeshkvi Pali. (Arben Hajdari)

PALIKUQI Hibe (1927-1944). Pjesëmarrëse e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare (LANÇ), Heroinë e Popullit. Lindi në Dibër. Ishte e bija e mësuesit Hafiz Palikuqi, familja e të cilit ishte përkrahëse e LANÇ-së. Në vitin 1942 kishte formuar një grup ilegal, i cili funksiononte në shtëpinë e saj. Për shkak të aktivitetit të saj kundër okupatorit, më 1943 u arrestua së bashku me nënën e saj. Pasi mbaroi dënimin, e vazhdoi veprimtarinë antifashiste. Në vitin 1944 u anëtarësua në Partinë Komuniste Shqiptare. U bë pjesë e batalionit partizan në rrethin e Dibër dhe u angazhua në organizimin e Brigadës XVIII, ku u emërua zëvendëskomisare e kompanisë. Në të gjitha luftimet u shqua për heroizëm dhe trimëri. Pjesëmarrja e saj në LNÇ ishte kontribut i rëndësishëm për emancipimin e femrës shqiptare. Më 23 shtator të vitit 1944 u vra gjatë luftimeve për çlirimin

e Kërçovës në Maqedoni. U shpall Heroinë e Popullit në Maqedoni dhe në Shqipëri. (Luan Tetaj)

PALOJA Adelina (1989-). Soprano. Lindi në Prishtinë, ku kreu shkollimin fillor e të mesëm për piano. Kreu studimet e solokëndimit në Fakultetin e Arteve (prof. M. Juniku), ndërsa



ADELINA PALOJA

ato pasuniversitare në Universitetin e Shkupit (prof. M. Muratovska-Naumovska) si studente e dalluar “Cum laude”. Nga viti 2009 është anëtare e Korit të Filharmonisë së Kosovës. Është aktive në jetën kulturore-artistike në

Kosovë dhe jashtë: pjesëmarrëse në festivalet “Re-Musica”, “DAM”, “Summa cum laude” (Vjenë), “Ditët e Muzikës Kosovare”, prezantime në Suedi, Zvicër, Shqipëri, Gjermani, Maqedoni, Holandë, me dirigjentë, si T. Shopov, R. Rudi, N. Marin, B. Jashari, S. Tatarçevski, B. Llapaj, N. Todorov; me role operistike, si Adina (“Lëlisir d’amore”), Amina (“La Sonnambula”), Pamina (“Die Zauberflute”), (“Cosi fan tutte”), Violetta (“La Traviatta”), Wally (“La Wally”) dhe solisitike: “Nji lule” e R. Muliqi, “Laudate Dominum” nga Mozart, “A Ceremony of Carols” e B. Britten, “O salutaris” e E. Esenvalds, “Kukuzeliana” & “Legjenda e varreve të hapura” e R. Rudi, “Gloria” e A. Vivaldit, “Requiem” e Mozart etj. Dy herë ishte fituese e çmimit të parë në “Ars Kosova”, pjesëmarrëse në “Hans Gabor Belvedere International Singing Competition” (Amsterdam, 2015) dhe “Neue Stimmen International Competition”. Është pedagoge e solokëndimit në Shkollën e Mesme të Muzikës në Prishtinë. (Arnisa Rexhepi)

PALOJA Bashkim (1944-). Piktur. Lindi në Gjakovë. Mori arsimin bazë në vendlindje dhe në Pejë, kreu Shkollën e Mesme të Artit në Pejë, ndërsa studimet për pikturë në Akademinë e Arteve Figurative në Beograd (1970). Po këtë vit në ekspozitën e përbashkët të studentëve mori çmimin e Universitetit për pikturë. Nga viti 1972 është anëtar Shoqatës së Artistëve Figurativë të Kosovës (SHAFK). Është ndër ekspresionistët më të shquar në Kosovë. Shtëpia e tij në Gjakovë, me atelienë dhe gjithë krijimtarinë artistike u dogj në tërësi nga ushtria

dhe policia serbe netët e para të bombardimeve të NATO-s në çaqet serbe (1999). Kjo ngjarje tronditëse la gjurmë të thella dhe më vonë do të pasqyrohet në punimet e realizuara pas lufte, të cilat i përmbloodhi në ciklin “Muzgu i shekullit XX”. Në këtë cikël dominon fryma ekspresive me kolorit të mbyllur, me një dritë të theksuar ekspresive-abstrakte. Si anëtar i SHAFK-ut mori pjesë rregullisht në ekspozitat tradicionale të saj, në vend e jashtë, në Sallonet Pranverore, në Ekspozitat Vjeshtore dhe në Bienalen e Vizatimit. Është fitues i disa çmimeve për pikturë. (Tahir Emra)

PALOKAJ Augustin (1969-). Gazetar. Lindi në fshatin Gurrakoc të Istogut. Shkollimin fillor dhe gjimnazin i mbaroi në Pejë, studimet në drejtimin e gazetarisë të Fakultetit të Shkencave Politike në Zagreb. Që kur ishte student nisi të punojë për mediet e Kosovës, të Kroacisë dhe ato ndërkombëtare. Punoi korrespondent i shërbimit botëror të BBC-së në gjuhën shqipe, kroate dhe angleze dhe botoi një sërë shkrimesh në gazetata kroate. Nga lufta në Kroaci shkroi raporte për të përjavshmen “Koha” në Prishtinë. Nga viti 1998 jeton në Bruksel, ku punon si korrespondent i gazetave “Jutarnji list” të Zagrebit dhe “Koha ditore” të Prishtinës. Raportoi nga Konferenca e Rambujesë për Kosovën, si dhe nga selia e NATO-s gjatë bombardimeve kundër Serbisë dhe hyrjes së trupave të NATO-s në Kosovë. Ndoqi shumë takime të nivelit të lartë të NATO-s dhe BE-së dhe intervistoi një sërë politikanësh botërorë. Punoi edhe si asistent demonstrator në Universitetin e Zagrebit dhe ligjëroi në shumë institucione ndërkombëtare. U shpërblye si gazetar në Kosovë dhe në Kroaci. (Artan Krasniqi)

PALUCA Anton (Ndue) (1881-1958). Mësues, publicist. Lindi në Gjakovë. Mësimet fillore i ka kryer në Prizren, ndërsa shkollën normale në Klagenfurt të Austrisë. Më 1914 u kthye në Vjenë për të mbaruar studimet universitare. Në Austri ishte aktiv në shoqërinë kulturore të studentëve shqiptarë “Dija”. Pasi normales u kthye në Prizren (1906), ndërsa pas një viti u caktua mësues në Arbnesh të Zarës. Në vitin 1912 e gjejmë në Shkup si përkthyes i konsullatës austro-hungareze. Ndërkaq, pas studimeve u kthye në Shkodër dhe ushtroi detyrën e administratorit dhe të shoqëruesit

të studentëve që çoheshin në Austri nga administrata shqiptare. N. Paluca ka qenë anëtar i rregullt i Komisionit Letrar të Shkodrës. Më vonë e ka vijuar veprimtarinë arsimore dhe të hartuesit të teksteve për shkolla. Më 1944, bashkë me Karl Gurakuqin, është vendosur në Salzburg të Austrisë, një kohë si refugjat. Dy studiuesit shqiptarë qenë angazhuar të hartonin Fjalorin shqip-gjermanisht. Nën drejtimin administrativ e shkencor të Paul Kretschmer nga Akademia Austriake e Shkencave, e cila i kishte marrë shpenzimet e projektit, ata e mbaruan hartimin e Fjalorit, duke e dorëzuar në skeda më 1947. Fjalori ruhet i plotë në kuti të mëdha skedash në Arkivin e Akademisë së Shkencave të Austrisë. Ka një parathënie dhe një skicë gramatikore. Më vonë Ndue Paluca ka mërguar në SHBA, ku ka vdekur në Buffalo. (Rexhep Ismajli)

PALUSHAJ Leonid (1980-). Piktore. Lindi në Pejë. Kreu arsimin fillor në Klinë, ndërsa Shkollën e Mesme të Artit në Pejë. Mbaroi Akademinë e Arteve, dega e pikturës, në Prishtinë. Ka filluar të ekspozojë që nga viti 2005, së pari në Galerinë e Ministrisë së Kulturës, pastaj në Qendrën Kulturore Franceze (Prishtinë, 2009) dhe në Gjermani (2010 dhe 2011), Shqipëri etj. Është pjesëmarrës në shumë ekspozita kolektive, si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Në vitin 2013 mori çmimin e parë në ekspozitën “Gara e artit global” në Prishtinë. Opusi i tij krijues përshkohet nga fryma ekspresive, surreale, me theks simbolik, metaforik, që më së miri shprehet në ciklin “Rrugëtimi”. (Hajrush Fazliu)

PALLASKA Fahri (1945-). Operator zëri. Lindi në Gjakovë. Gjymnazin e mbaroi në Prishtinë. Më 1972 filloi punën si asistent tonist në Radiotelevizionin e Beogradit, redaksia në gjuhën shqipe. Me hapjen e Televizionit të Prishtinës (TVP) më 1974, vazhdon ta ushtrojë profesionin në këtë medium. Ishte operator zëri në një sërë emisionesh dokumentare, spektakle televizive, filma dokumentarë, seriale, drama dhe filma televizivë dhe filma të metrazhit të gjatë (“Të shtëna në ajër”, “Kulla”, “Lulepeshkat e dashurisë”, “E kafshoja terrin”, “Kopshti i pleqërisë” etj.). (Shaqir Foniqi)

PALLASKA Gazmend (1955-). Këngëtar, avokat. Lindi në Prishtinë, ku kreu filloren, të

mesmen dhe Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës. Filloi të këndojë më 1969. Mori pjesë në disa festivale për talentet e reja dhe fitoi disa çmime të para. Në garën e TV Beogradit “Maximetër” mori vendin e parë, në festivalin e Zveçanit çmimin e këngëtarit më të mirë. Ka marrë pjesë në “Akordet e Kosovës”, në festivalin e Opatisë, të Zagrebit, të Splitit dhe të qendrave të tjera të ish-Jugosllavisë. Ka kënduar në Kosovë, Shqipëri, në disa vende të Europës Perëndimore dhe ish-Bashkimit Sovjetik. Më 1973 me Z. Çoliq (Beograd) e D. Mijallkovski (Shkup) u shpallën treshja më e mirë në ish-Jugosllavi. Incizoi në të gjitha studiot e radiotelevizioneve jugosllave. Bashkëpunoi me kompozitorët: T. Berisha, S. Kajtazi, Gj. Kaçinari, S. Alimanoviç, M. Piperku, A. Koraç, Z. Skerl, N. Kallogjera, B. Adamiq, Mihaljinca, M. Prohaska etj. Më 1980 iu dha dekorata “Artist i Estradës Jugosllave”. Ishte themelues e kryetar i Shoqatës së Artistëve të Estradës dhe Interpretëve të Kosovës (1979), i Klubit të Artistëve të Prishtinës dhe themelues e drejtor i Band-it të Radiotelevizionit të Kosovës. (Indira Çipa)

PALLASKA Gresa (1980-). Aktore. Lindi në Prishtinë, ku mbaroi arsimin fillor dhe të mesëm. Kreu studimet për aktrim në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. Filloi




GRESA PALLASKA

krijmtarinë artistike si aktore gjatë kohës sa ishte studente me disa role në Teatrin Kombëtar të Kosovës në shfaqje të tilla si: “Fausti III”, “Makbethi” dhe “Togeri i Inishmorit”, pastaj në Teatrin “Dodona” në shfaqjet “Menaxheria e qelqtë”, “Mësimi i ndaluar”, ndërsa në Teatrin Oda në shfaqjet “Monologjet e vaginës” dhe “Possibilities”. Pas diplomimit (2004) luajti në Teatrin Kombëtar të Kosovës në shfaqjet: “Shtëpia e Bernarda Albës”, “Roberto Xuko”, “Antidogma”, “Zeka i zi”, “Çifti Martin”, “Më afër”, “Rock’n’Roll”, si dhe “Pas zonjushës Julie”. Në Teatrin e Gjakovës gjithashtu ka luajtur në shfaqjet “Hanibali i nëntokës” dhe “Hiqe ministrin nga priza”. Në Teatrin Shqiptar të Shkupit ka luajtur në shfaqjet “Akuariumi”, “Opera e lypsarëve”, “Jetë me qira”. Ka luajtur edhe në shfaqjen “Leksikoni i mitologjisë

jugosllave”, që ishte bashkëprodhim i disa teatrove nga hapësirat e ish-Jugosllavisë. Përveç teatrit, ka luajtur edhe në disa filma të metrazhit të gjatë (“Shkaba”, “Ana Frank”, “Requiem for Europe”), si dhe në disa filma të metrazhit të shkurtër. Njihet si aktore e disa serialeve televizive, si: “Familja moderne”, “Kafeneja jonë “Amkademiku”, “Çka ka shpia” etj. Për kreacione autoriale u nderua me disa çmime si aktorja më e mirë në festivale dhe konkurse. (Bekim Lumi)

PALLASKA Shani (1928-1999). Aktor. Lindi në Gjakovë. Ishte aktori i parë i angazhuar në trupën shqiptare të Teatrit Popullor Krahinor (TPK). Kishte aftësi të veçanta transformuese në




SHANI PALLASKA

karaktere të ndryshme. Aktroi me sukses role të rëndësishme, njësoj si në role dytësore dhe episodike, si në tragjedi e dramë, ashtu edhe në komedi. Në skenën e TPK-së realizoi një numër të madh rolesh, shumë prej tyre kryesore. Ishte ndër aktorët më të shpërblyer në Takimet e teatrove “Joakim Vujiq” të cilat mbaheshin çdo vit në qytete të ndryshme të Serbisë dhe të Vojvodinës, ku mori çmime për rolet: Jerotie në “Personi i dyshimtë” (Beograd, 1950), Kunati në “Erveheja” (Nish, 1967), Vladimiri në “Duke pritur Godonë” (Leskovc, 1970), “Gjenerali në “Gjenerali i ushtrisë së vdekur” (Kragujevc, 1973), Kristiani në dramën “Golgota” (Nish, 1974) dhe Nado në “Shtetrrethimi” (Uzhicë, 1974). Rolet ku doli në pah e gjithë fuqia aktoriale e Sh. Pallaskës konsiderohen: Vladimiri në “Duke pritur Godonë” në regji të L. Millosheviqit (1970), Gjenerali në “Gjenerali i ushtrisë së vdekur” në regji të P. Manit (1973) dhe Sëri në “Garderobisti” në regji të S. Tarakut (1995). Sh. Pallaska realizoi me sukses edhe një numër rolesh në filmat: “Era e mollës” (1995), “Tre vetë kapërcejnë malin” (1981), “Gjurmët e bardha” (1980), “I ikuri” (1980), “E kafshoja terrin” (1977), “Si të vdiset” (1972), “Të ngujuarit” (1971), “Uka i Bjeshkëve të Nemuna” (1968), “Kapedan Lleshi” (1960), “Vizitë natën” (1978), “Sulmi i kuq” (1974), “Buka” (1973) dhe në seritë televizive “Kur pranvera vonohet” (1980) dhe “Era e Lisi” (1979). Prej vitit 1974 deri më

1978 ishte drejtor i TPK-së. Për kontributin në teatër dhe film u nderua me një sërë çmimesh dhe mirënjohjesh. (Fadil Hysaj)

PALLASKA Talat (1930-2011). Mjek otorinolaringolog, profesor universitar. Lindi në Gjakovë, gjimnazin e kreu në Prishtinë, ndërsa studimet në Fakultetin e Mjekësisë në Beograd



TALAT PALLASKA

(1958). Në vitet 1959-1974 shërbeu si mjek në Spitalin e Përgjithshëm të Prishtinës, si përgjegjës i pavijonit të otorinolaringologjisë (1964-1972) dhe më pas drejtor i Spitalit të Përgjithshëm (1972-1974). Në vitin 1972

mori titullin primarius. Ndërkohë u specializua për otorinolaringologji (ORL) dhe kirurgji cervikale në Beograd, ndërsa nga viti 1972 ishte pedagog në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës, ku kreu edhe detyra drejtuese, përfshirë edhe atë të dekanit në periudhën 1979-1981 dhe të drejtorit të Klinikës dhe përgjegjës i katedrës së ORL-së. Mbrojti tezën e doktoratës më 1977 në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë dhe më pas mori titujt përkatës universitarë, përfshirë edhe titullin profesor ordinar. U detyrua të jepte dorëheqje nga detyra e drejtorit të Klinikës në vitin 1990, si nënshkrues i “Apelit të 215” dhe më 1991 u largua me dhunë prej saj. Në qershor të vitit 1999 u rikthye në Klinikë, ku punoi derisa doli në pension (2001). Është autor i tekstit universitar “Otorinolaringologjia” (1994) dhe ka botuar një sërë punimesh në revista të ndryshme profesionale e shkencore. Në vitin 1988 në Prishtinë organizoi Kongresin XIII të Otorinolaringologëve të ish-Jugosllavisë. Ishte kryetar i Shoqatës së Mjekëve të Kosovës, kryetar i Shoqatës së Arsimitarëve Universitarë të Kosovës, anëtar i redaksisë së revistës “Symposia ORL Yugoslavica” dhe i revistës “Praxis Medica”. (Isuf Dedushaj)

PALLATI I NERODIMES. Kompleks villo me termë, i ndërtuar në shek. IV dhe i rindërtuar në shek. V-VI. Gjendet në fshatin Nerodime të Poshtme, në anën e majtë të rrugës Ferizaj-Jezerc. U ngrit nga bloqe gurësh dhe gurë mesatarë, të lidhur me llaç gëlqereje (120 m²). Është zbukuruar me mozaikë dhe afreska. Ka

katër kthina dhe një korridor të lidhur njëra më tjetrën, që komunikojnë përmes hyrjeve. Në mes ndodhet fontana me mozaik. Veçohet qendra në formë drejtkëndore (8.5 x 8 m), e zbukuruar me mozaik dyshemeje. Brendia e mozaikut ka motive të rozetave të vendosura në katror, ndërsa korniza ka motive të zogjve dhe të bimëve. Mozaiku është realizuar me zaje të bardhë, të kuq, të kaltër e të verdhë, me nuancat e tyre. Në anën perëndimore të dyshemesë është fusha mbishkrimore e kornizuar, ku në katër rreshta janë shkruar në latinisht emrat e shtatë dijetarëve të antikës: Periandrit nga Korinti, Hilonit nga Sparta, Pitakusit nga Mitililena, Solonit nga Athina, Talesit nga Mileti, si dhe emrat e dy të tjerëve, që nuk mund të lexohen, ngase gjenden në anën e pagërmuar të dyshemesë. Pranë emrave është shkruar edhe nga një thënie e tyre. Sipër mbishkrimit gjenden portretet e dijetarëve, të përkufizuara me arkada. Janë ruajtur pjesërisht vetëm dy portrete. Gërmimet i zhvilloi Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës (1988). Kompleksi nuk u zbulua i tëri. (Haxhi Mehmetaj)

PALLATI I RINISË, PRISHTINË (Arki-tekstura). Ndërtesë e një rëndësie të posaçme për identitetin e qytetit të Prishtinës, me arkitekturë të dalë nga një sistem shoqëror pa



PALLATI I RINISË

kufizime ideologjike apo kombëtare, bazuar në mjediset dhe tendencat europiane, në stilin e metabolizmit japonez të viteve '60 të shekullit të kaluar. U projektua në vitin 1977 nga arkitekti Zh. Jankoviç dhe H. Muhasiloviç, sipas konceptit të planit urbanistik të Kuvendit Komunal të aprovuar më 18.2.1975. Ndërtesa sportive-rekreative, komerciale dhe e biznesit ish-”Boro e Ramizi” në Prishtinë, me sipërfaqe

shfrytëzuese rreth 50,000 m² dhe me njërën ndër sallat sportive më të mëdha, konsiderohej si ndërtesa më e bukur në qytet dhe një nga më të bukurat në ish-Jugosllavi. Qendra, e ndërtuar me kontributin e qytetarëve të Prishtinës, në fillim u emërua “Boro e Ramizi”, sipas dy luftëtarëve komunistë të vranë gjatë LNÇ-së. Qendra ka sallën universale, sallën e madhe për basketboll, hendboll, futboll të vogël, sallën e vogël me 3,000 vende dhe sallën e akullit me 8,000 vende. Hapësira e mesme e qendrës përfshin një sipërfaqe prej 10,000 m², në të cilën organizohen manifestime të ndryshme. Pjesa lidhëse përbëhet nga qendra tregtare me afro 120 lokale me sipërfaqe prej 8,200 m² mbi të cilën është pllatoja. Pjesa e tretë paraqet shtëpinë e të rinjve, me galeri, dy salla, “sallën e kuqe” me 800 ulëse dhe amfiteatrin me 500 ulëse, në të cilën organizohen manifestime të ndryshme kulturore, artistike, panaiire, festivale, koncerte etj. Në qershor të vitit 2000, Pallatin e Rinisë e kaplon zjarri, me ç’rast pësojnë dëmtime të mëdha pjesa e palestresë së madhe dhe disa hapësira të tjera. (Vlora Navakazi)

PALLOSHI Rifat (1927-2007). Mjek, internist, kardiolog, primarius. Lindi në Tetovë, arsimin fillor dhe gjimnazin e ulët e kreu në vendlindje, pastaj vazhdoi në Tiranë dhe më pas në Prishtinë. Në vitin 1944 u kthye në Tetovë. Pasi regjistroi Fakultetin e Mjekësisë në Shkup, u arrestua për shkak të propagandës kundër shpërnguljes së shqiptarëve për në Turqi. U dënua me 5 vjet heqje lirie dhe u dërgua në burgun e Idrizovës. Pas daljes nga burgu vazhdoi studimet për mjekësi në Universitetin e Shkupit, të cilat i përfundoi më 1959. Ndërkohë, bëri specializimin në lëmin sëmundjeve të brendshme në Tetovë dhe në Shkup (1969). Ishte njëri ndër themeluesit e shërbimit internistik në Qendrën Mjekësore në Tetovë. Kreu subspecializimin nga kardiologjia. Dha kontribut të çmuar në zhvillimin e shëndetësisë në trevën e Tetovës. Ishte bartës i shumë mirënjohjeve për humanizëm dhe punë profesionale. (Remzi Izairi)

PANAIRET. Tubime tradicional i prodhuesve në treg, në të cilën mblidhen kompani të shumta për të ekspozuar apo për të shitur prodhimet e veta, që i takojnë zakonisht industrisë ose sektorëve të ngjashëm. Disa panaiire zgjasin vetëm një pasdite, përderisa të tjerët mund

të zgjasin deri në dhjetë javë. Aktivitetet në panairë janë të shumëllojshme. Panairët janë të njohur edhe me emra të ndryshme nëpër botë, të tilla, si: shfaqje bujqësore, panair i qarkut, ekspozitë, festival, treg etj. Kosova ka një traditë relativisht modeste në organizimin e panairëve, me një zhvillim më intensiv viteve të fundit. Disa nga panairët e rregullta që organizohen në Kosovë janë: panairi i librit, panairi i përgjithshëm ndërkombëtar, panairi financiar, panairi i produkteve bujqësore, panairi i edukimit etj. Kosova ka ndërtuar edhe Qendrën e Panairëve në afërsi të Prishtinës (fshati Bërnice). (Besnik Krasniqi)

PANTINA. Fshat në veriperëndim të Vushtrrisë, rreth 6 km larg nga qendra komunale. Shtrihet në Rrafshin e Kosovës, në anën e majtë të lumit Sitnica, në lartësi mbidetare 550 m. Është vendbanim i tipit të dendur, me zonën kadastrale prej 484 ha. Popullsia merret kryesisht me bujqësi. Sipas defterit osman të vitit 1455, Pantina kishte 55 shtëpi, në vitin 1914 kishte 455 banorë, në vitin 1991 kishte 1,855, kurse tani në të jetojnë rreth 2,000 banorë. Ka shkollë 9-vjeçare, shoqëri kulturore-artistike, zyrën e bashkësisë lokale, disa njësi tregtie etj. (Ibrahim Ramadani)

PANTINA Xhevdet (1981-). Piktur. Lindi në Gllarevë të Klinës. Mori shkollimin bazë në Gllarevë dhe në Pejë, ndërsa studimet i kreu në Fakultetin e Arteve në Prishtinë. Në fillim



XHEVDET PANTINA

punoi si mësimdhënës i artit në shkollën fillore të Gllarevës, më pas u zgjodh asistent i vizatimit e më vonë profesor në Fakultetin e Arteve në Prishtinë. Ishte kryetar i Shoqatës së Artistëve Figurativë të Kosovës për dy mandate. Bëri specializime në Paris, në Akademinë e Arteve të Bukura, për teknikën e ngjyrave “Ebru art”, si dhe në Milano e Ankara. Hapi ekspozita personale në “Qendrën rinore” në Pejë (2002), në Muzeun Kombëtar në Prishtinë (2010), në Galerinë e Fakultetit të Arteve në Prishtinë (2014), ndërsa jashtë ekspozoi në Manhaime të Gjermanisë, në Muzeun e Gjirakastres (2010), në Universitetin Ruan në Paris (2013) dhe në Muzeun e Artit Bashkëkohor

“Çankaya” në Stamboll (2015). Gjithashtu mori pjesë në disa ekspozita të përbashkëta vendore dhe ndërkombëtare. Është profesor i vizatimit analitik dhe i pikturës në Fakultetin e Arteve në Prishtinë. (Bislim Aliu)

PAPAZOGLU Fanula (1917-2001). Historiane serbe, filologe. Lindi në Manastir (Maqedoni) dhe kreu studimet për filologji klasike me histori dhe arkeologji antike në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Beogradit (1946), ku mbrojti dhe doktoratën (1955). Më parë u burgos dhe u mbajt në kampin e përqendrimit në Banjicë për shkak të aktiviteteve antifashiste (1942-1943). Nga viti 1947 punoi në departamentin e historisë antike të Universitetit të Beogradit dhe drejtoi qendrën për epigrafi dhe numizmatikë antike. Botoi një sërë punimesh shkencore mbi antikitetin. Në vitin 1983 u zgjodh anëtare e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Serbisë. Ishte anëtare korrespondente e Institutit Arkeologjik të Gjermanisë, doktore nderi e Universitetit të Sorbonës, anëtare e Akademisë së Shkencave dhe e Arteve të Maqedonisë. Ndryshimi i qëndrimeve rreth dardanëve nuk e zbeh kontributin e saj për njohjen e dardanëve dhe fiseve të tjera ilire në librin “Fiset e Ballkanit Qendror në periudhën romake”. (Pleurat Kabashi)

PAPUNËSIA. Paraqet numrin e të papunëve në kuadër të fuqisë punëtore, ndërsa norma e papunësisë shpreh raportin ndërmjet të papunëve dhe fuqisë punëtore. Të papunë janë personat që plotësojnë këto kushte: nuk janë të punësuar, kryejnë aktivitete që mund të çojnë në gjetjen e vendit të punës dhe janë të gatshëm të pranojnë një punë nëse u ofrohet. Si rregull, papunësia rritet gjatë krizës ekonomike dhe bie gjatë ekspansionit ekonomik. Papunësia konsiderohet në rritje, nëse hyrjet në grupin e të papunëve janë më të mëdha se daljet nga ky grup. Papunësia afatgjate paraqet përqindjen e të papunëve, të cilët janë të papunë për më shumë se një vit. Të papunët e tillë mund të humbasin aftësitë dhe shkathtësitë produktive që kanë fituar më parë, duke u bërë më pak të përshtatshëm për punësim dhe më pak të kërkuar në tregun e punës. Sipas të dhënave për vitin 2014, në Kosovë norma e papunësisë ka qenë 35,3% (apo 176,743 persona të papunë të moshës 16-64). Nga ky numër, meshkuj ishin 123.052 dhe femra 53,691. Norma e

papunësisë në Kosovë është më e lartë për të rinjtë, për femrat dhe për personat me arsim të ulët krahasuar me grupet e tyre respektive. Për moshën deri në 24 vjeç, norma e papunësisë ishte 61%, ndërkaq për grupmoshën 45-54 vjeç ishte 23.6%. Norma e papunësisë për meshkuj ishte 33.1%, ndërkaq për femra 41.6%. Norma e papunësisë për personat me arsim fillor ishte 46%, krahasuar me 18.9% për personat me arsim të lartë. Të papunë afatgjatë, që kërkojnë punë më shumë se një vit janë 68.9% të të papunëve. (Avdullah Hoti)

PARAJA. Instrument përgjithësisht i pranuar si mjet për blerjen e mallrave dhe shërbimeve si dhe për shlyerjen e borxheve në një vend të caktuar ose në një kontekst socioekonomik. Paraja ka katër funksione themelore, duke shërbyer si mjet këmbimi (mjet për blerjen e mallrave, të shërbimeve dhe asetëve financiare dhe jofinanciare, pa përdorur trampën si formë shkëmbimi), ruajtëse e vlerës (mjet për mbajtjen e pasurisë), njësi llogaritare (standard për denominimin e çmimeve të mallrave dhe shërbimeve) dhe standard i pagesës (mjet për të lidhur vlerat aktuale dhe të ardhshme në kontratat financiare). Kosova pas vitit 1999 në mënyrë unilaterale adaptoi markën gjermane si valutë zyrtare. Në vitin 2002, në bashkëpunim me Bankën Qendrore Europiane dhe me disa banka qendrore të shteteve anëtare të eurozonës, Kosova adoptoi euron si valutë zyrtare. (Valentin Toçi)

PARALELET E KOMBINUARA. Paralele mësimore të përbëra prej dy deri në tri klasë, ku në të njëjtën kohë të gjithë nxënësve u mban mësim një mësues. Mësimi në paralele të tilla organizohet për shkak të numrit të vogël të nxënësve, ose për shkak të mungesës së mësimdhënësve. Paralelet e tilla, sidomos në zonat rurale, kanë një traditë më të hershme në Kosovë, por mësimi i tillë është i pranishëm edhe sot. Me legjisllacionin kosovar (2009) paralelet e kombinuara mund të formohen me klasë të përziera (2-3 klasë) në raste kur një paralele e ndarë ka më pak se dhjetë nxënës. Lëvizja e popullsisë nga zonat rurale në qendrat urbane dhe emigrimi në botën e jashtme ndikoi që numri i nxënësve në fshatra, sidomos në zonat malore, të zvogëlohet ndjeshëm. Në zona të tilla me më pak nxënës mësimi shpesh organizohet në paralele të kombinuara. Gjatë

dhjetëvjeçarit të fundit në paralele të tilla në Kosovë çdo vit mësimin e vijonin, me oscilime, rreth 2,500 nxënës të shkollës fillore. Në vitin shkollor 2014/15 kishte 2,702 nxënës të tillë. Mësimi në paralele të tilla organizohet sipas një metodike të veçantë. (Azem Azemi)

PARALELET E NDARA. Klasë paralele, fizikisht të ndara nga shkolla amë. Themelohen në vendbanime të caktuara për nxënësit, të cilët për shkak të largësisë dhe kushteve të vështira nuk kanë mundësi t'i vijojnë mësimet në shkollën amë. Paralele të tilla kanë shkollat fillore dhe të mesme. Në arsimin kosovar paralele të ndara kishte dhe ka në të gjitha komunat. Numri i tyre ka shkuar duke u zvogëluar. Sipas udhëzimit të Ministrisë së Arsimit të Shkencës dhe të Teknologjisë (2011), një paralele e ndarë nuk duhet të ketë më pak se pesë as jo më shumë se njëzet nxënës. Mësimi në paralele të tilla organizohet sipas Kornizës së kurikulës së Kosovës. (Vlora Sylaj)

PARIPOVIQ (Paripović) Ramiz (1931-2014). Mjek, pediatër, profesor universiteti. Lindi në Berane (Mali i Zi), shkollimin e kreu në vendlindje, ndërsa studimet në Fakultetin e Mjekësisë në Beograd (1958). Pas diplomimit u punësua në Spitalin e Fëmijëve në Prishtinë, më vonë Klinika e Pediatrisë. Specializoi për pediatri dhe subspecializoi pulmologjinë e fëmijëve. Mbrojti tezën e disertacionit në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë (1984). Ishte për shumë vjet shef i repartit për sëmundje të mushkërive dhe tuberkuloz në Klinikën e Pediatrisë. Arriti të gjithë titujt universitarë, përfshirë edhe titullin profesor ordinar i lëndës së pediatrisë në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë, me mësim në gjuhën serbokroate. Publikoi një numër të madh punimesh shkencore brenda dhe jashtë vendit. (Mehmedali Azemi)

PARITETI I FUQISE BLERËSE. I njohur edhe si PPP (purchasing power parity) është koncept për të krahasuar diferencat në nivelin e të ardhurave midis vendeve të ndryshme, të cilat nuk shprehen në tërësi vetëm përmes prodhimit të brendshëm bruto (PBB) për një banor, sepse një sasi e njëjtë parash ka fuqi të ndryshme blerëse në vende të ndryshme. Koncepti i paritetit të fuqisë blerëse mundëson të vlerësohet sa duhet të jetë norma e këmbimit

ndërmjet valutave, në mënyrë që këmbimi të jetë i bazuar në fuqinë blerëse të valutave të caktuara. Meqenëse PBB-ja llogaritet në bazë të valutës vendore, atëherë krahasimi i PBB-ve të vendeve të ndryshme duhet të bëhet në valutë të njëjtë, siç është dollari amerikan apo euroja, por gjithmonë duke aplikuar konceptin e paritetit të fuqisë blerëse, sepse një euro, ta zëmë, ka fuqi të ndryshme blerëse në dy vende të ndryshme. Pariteti i fuqisë blerëse llogaritet duke marrë për bazë një shportë produktesh dhe shërbimesh dhe në bazë të kësaj llogaritet koeficienti i fuqisë blerëse, zakonisht në krahasim me vendet e caktuara ose mesataren e OECD-së. Kosova nuk e ka të llogaritur zyrtarisht paritetin e fuqisë blerëse, por për disa vende me nivel të ngjashëm zhvillimi ky koeficient është midis 2-3 që do të thotë se 100 euro në Kosovë kanë më shumë fuqi blerëse, përkatësisht sa 200-300 euro në vendet e OECD-së për shkak të çmimeve më të ulëta të produkteve dhe shërbimeve. (Alban Zogaj)

PARKU KOMBETAR I BJESHKËVE TË NEMUNA. Park kombëtar në Bjeshkët e Nemuna, në perëndim të Kosovës. Për shkak të vlerave natyrore të veçanta: gjeologjike-gjeomor-



PEIZAZH NGA BJESHKËT E NEMUNA

fologjike-hidrologjike (morena, cirqe, lugina dhe liqene akullnajore, gryka lumore, vrella karstike, shpella, etj.), klimatike, floristike (bëgat e pasur bimore dhe lloje endemike), faunistike, peizazhore etj., Bjeshkët e Nemuna janë

shpallur park kombëtar më 2012, me sipërfaqe prej 62,488 ha. Bjeshkët e Nemuna paraqesin njërin nga masivet malore dhe më komplekse në Kosovë dhe Ballkan. Shtrihen në territorin e pesë komunave: Pejë (52 %), Deçan (27%), Junik (8%), Istog (8%) dhe Gjakovë (5%). Është ndër masivet malore më të rëndësishme në Ballkan, për sa i përket llojllojshmërisë së florës dhe vegjetacionit. Janë të pranishme mbi 1,000 lloje të bimëve: relikte, endemorelikte dhe endemike autoktone të Ballkanit dhe Europës, pa përfshirë myshqet, likenet dhe kërpudhat. Në zonat alpine dhe subalpine janë 33 lloje endemike, 6 lloje subendemike, 128 lloje endemike të Ballkanit. Ndër llojet endemike të Kosovës janë: burgulli i Koshanit (*Sempervivum kosaninii*), cefalaria e Pashtrikut (*Cephalaria pastricensis*), arithja e Fialit (*Astragalus fialae*), akoniti i Rusolisë (*Aconitum pentheri*), manaferra e Pejës (*Rubus ipecensis*), iriqëza e Sharrit (*Saxifraga scardica*), vulfenia e Bleçiqit (*Wulfenia blecicii*) kokoçeli (*Centaurea nervosa*), tlaspi (*Thlaspi cuneifolium*), listra e Rohleries (*Thymus rohlena*) etj. Nga llojet relikte më karakteristike janë: shkoza e zezë (*Carpinus orientalis*) dhe shkoza e bardhë (*Carpinus betulus*), të përhapura në kuadër të pyjeve të dushkut dhe ahut. Janë të pranishme edhe shumë lloje endemike të Ballkanit, ndër të cilat edhe shmanga shqiptare (*Crepis albanica*), draba e Korabit (*Draba korabensis*), cerast dinarik (*Cerastium dinaricum*), burgulli maqedonas (*Sempervivum macedonicum*), qumështorja mala-zeze (*Euphorbia montenegrina*) etj.

Bjeshkët e Nemuna karakterizohen me faunë të pasur, e cila ka ardhur si rezultat i ndikimeve të shumta të rajonit mesdhetar, eurosiberian dhe nordiko-alpin, si dhe i ndryshimeve të shpeshta të kushteve ekologjike në të kaluarën. Fauna përbëhet prej: 8 lloje peshqish, 13 lloje ujëtokësorësh, 10 lloje zvarranikësh, 178 lloje shpendësh, 37 lloje gjitarësh etj. Fauna përfaqësohet nga: rrëqebulli (*Lynx lynx*), ariu i murrmë (*Ursus arctos*), kaprolli (*Capreolus capreolus*), dhia e egër (*Rupicapra rupicapra*), shqiponja perandorake (*Aquila heliaca*), shqiponja e maleve (*Aquila chrysaetos*), fajkoi thonjbardhë (*Falco naummani*), pulegra (*Tetrao urogallus*) etj, që kanë status të mbrojtur kombëtar dhe ndërkombëtar.

Me qëllim të menaxhimit të parkut në përputhje me dispozitat ligjore (04/L-086), është

bërë ndarja në zona dhe është vendosur regjimi i mbrojtjes: zona e parë me 16 njësi (me veçori natyrore të jashtëzakonshme, lloje të rralla, të rrezikuara të bimëve dhe shtazëve dhe tipave të vendbanimeve në kushte të natyrës së egër) përfshin sipërfaqe prej 8,452 ha ose 13.3%; zona e dytë (karakterizohen me ekosisteme, peizazhe dhe vlera të tjera të natyrës, ku mund të ushtrohet ekoturizmi, bujqësia tradicionale dhe veprimtaritë që nuk janë në kundërshtim me qëllimet e mbrojtjes) me sipërfaqe prej 40,966 ha, ose 65%; dhe zona e tretë (ku mund të bëhet ndërtimi, rindërtimi, mbrojtja e objekteve tradicionale dhe për rekreacion, pastaj turizëm dhe për nevoja të ndryshme të banorëve në territorin e Parkut, si dhe shfrytëzimi i kullosave dhe të mirave të natyrës) përfshin sipërfaqen prej 13,637 ha ose 21.7% të sipërfaqes së Parkut. Në një periudhë më të hershme (1955-1988), në Bjeshkët e Nemuna janë shpallur si zona të veçanta të kategorive të ndryshme të mbrojtura: Maja e Ropsit (rezervat bimor i molikës, bredhit, pishës, ahut; sipërfaqja 25 ha), malet e Prilepit (rezervat i panjës malore; sipërfaqja 0.92 ha), Gubavci (rezervat i boshtres; sipërfaqja 38 ha), Kozhnjari (rezervat i dhisë së egër, sipërfaqja 161 ha), Gryka e Rugovës (monument natyre me rëndësi gjeologjike, hidrologjike, peizazhore, speleologjike, botanike; sipërfaqja 4,301 ha) dhe Burimi i Drinit të Bardhë me shpellën e Radavcit (monument natyre me rëndësi gjeologjike, hidrologjike, peizazhore, speleologjike; sipërfaqja 90 ha). Parku Kombëtar i Bjeshkëve të Nemuna ka rëndësi të veçantë shkencore, edukative-arsimore, kulturore-historike, rekreative-turistike dhe ekonomike. Administrohet nga drejtoria e Parkut me seli në Pejë. (Fadil Bajraktari)

PARKU KOMBETAR I SHARRIT. Park kombëtar në jug të Kosovës. Për shkak të vlerave të veçanta natyrore, gjeologjike-gjeomorfologjike-hidrologjike (morena, cirqe, lugina dhe liqene akullnajore, gryka lumore, burime karstike etj.), klimatike, të florës (begati e pasur bimore dhe lloje endemike), faunës dhe peizazheve, Malet e Sharrit janë shpallur park kombëtar (1986) me sipërfaqe 39,000 ha, e cila më vonë u zgjerua në 53,469 ha (2013). Shtrihet në pjesën jugore të Kosovës, në 5 komuna: Dragash (45.1%), Shtërpçë (23.9%), Prizren, (22.2%), Suharekë (4.7%) dhe Kaçanik (4.1 %). Kufiri jugor i Parkut përpunet me vijën kufit-



PEIZAZH NGA MALET E SHARRIT

are me Maqedoninë dhe Shqipërinë dhe kalon nëpër majat më të larta të Maleve të Sharrit. Në kuadër të Parkut janë përfshirë tërësitë natyrore: Koritniku, pjesa jugore e Gorës, Brezovica, Luboteni, Oshlaku, Koxhaballkani, Ostrovica etj.

Vegetacioni përfaqësohet nga sipërfaqet barishtore (kullosat 58%) dhe pyjore (bredhit, hormoçit, pishës së bardhë, pishës endemike dhe relikte të maleve të larta: rrobulli (*Pinus heildreichii*) dhe molika (*Pinus peuce*) me 35%. Kullosat paraqiten në pjesët e sipërmeve, mbi vegetacionin drunor. Pjesa më e madhe e kullosave shtrihet në komunën e Dragashit, të cilat paraqesin sipërfaqen më të madhe të kullosave të maleve të larta në Europë. Parku Kombëtar i Sharrit përfshin një pjesë të Maleve të Sharrit që janë më të pasurat në Kosovë dhe në Gadishullin Ballkanik me lloje bimore endemike e relikte. Janë evidentuar 2,000 lloje bimore (400 bimë endemike, 20 lloje stenoendemike, mbi 250 bimë mjekësore, afro 160 lloje drunore) dhe mbi 180 bashkësi bimore. Faunën e përbëjnë 32 lloje të gjitarëve (pa lakuriqët), 12 lloje të ujëtokësorëve, 200 lloje të shpendëve dhe 147 lloje të fluturave ditore. Gjitarët e mëdhenj janë: ariu i murrmë, kaprolli, dhia e egër, rrëqebulli, ujku, derri i egër etj.

Me qëllim të menaxhimit, në përputhje me dispozitat ligjore (04/L-087) është bërë ndarja nëpër zona dhe është vendosur regjimi i

mbrojtjes së këtij parku natyror. Janë përcaktuar tri zona me regjim të ndryshëm të mbrojtjes: zona e parë, me veçori natyrore të jashtëzakonshme, lloje të rralla, të rrezikuara të bimëve e shtazëve dhe tipave të vendbanimeve në kushte të natyrës së egër (përfshin sipërfaqe prej 9,363.51 ha ose 17.5%); zona e dytë, që karakterizohet me ekosisteme, peizazhe dhe vlera të tjera të natyrës, ku mund të ushtrohen ekoturizmi, bujqësia tradicionale dhe veprimtaritë, të cilat nuk janë në kundërshtim me qëllimet e mbrojtjes (kap sipërfaqen prej 40,311.9 ha ose 75.4%); dhe zona e tretë, ku mund të bëhen ndërtime, rindërtime, mbrojtje të objekteve tradicionale dhe rekreacion, turizëm, si dhe shfrytëzim i kullosave dhe të mirave të natyrës (përfshin sipërfaqe prej 3,769.8 ha ose 7.1%). Në kuadër të zonës së parë janë veçuar: Koxhaballkani (Pisha e Madhe), Oshlaku, Maja e Arnenit (Prevala) dhe Rusenica. Pisha e Madhe, rezervat i pyjeve të pastra të rrobullit (*Pinus heildreichii*), në shpatet juglindore të Koxhaballkanit paraqet kompleksin e pyjeve të Arnenit, me sipërfaqe 35 ha, më të veçantat në Gadishullin Ballkanik. Oshlaku, me sipërfaqe 20 ha, rezervat i pyjeve të pastra të rrobullit (*Pinus heldreichii*), i pasur me bimë endemike, veçohet për llojin stenoendemik (*Achillea alexandri - regis*), që gjendet kryesisht në pjesët e larta malore. Nga fauna shquhet: dhia e egër (*Rupicapra rupicapra*), ariu i murrmë, ujku, kaprolli dhe shpendë të tjerë. Maja e Arnenit, lokalitet me pyje të llojit endemik dhe relik i terciarit të rrobullit (*Pinus heldreichii*), me sipërfaqe prej 30 ha, është i pasur me bimë endemike, nga të cilat veçohen: barpeshku i Sharrit (*Vrbascum scardicum-st. end.*), gencianëza bullgare (*Gentianella bulgarica var. Albanica*), karafili i kartusianëve (*Dianthus cartusinarum*), karafili i shkëmbinjve (*Dianthus integer*), lulekambana shqiptare (*Campanula albanica*), lisra shqiptare (*Thymus albanus*) etj. Rusenica është rezervat i rrëqebullit ballkanik (*Lynx Lynx balcanicus*), me sipërfaqe prej 300 ha, ku veçohet lloji i panjës malore (*Acer heldreichii*). Parku Kombëtar i Sharrit ka rëndësi të veçantë shkencore, edukative-arsimore, kulturore-historike, rekreative-turistike dhe ekonomike. Administrohet nga drejtoria e Parkut me seli në Prizren. (Fadil Bajraktari)

PARLAMENTI I PARË DHE I DYTË OSMAN (1876-1920). Për herë të parë u hap në fund të vitit 1876, me shpalljen e kushtetutës

së parë osmane. Në shkurt të vitit 1877 u mbajtën zgjedhjet e përgjithshme, me çrast nga myslimanët u zgjodhën 69 deputetë dhe 46 nga të krishterët, ndërsa kryetar i parlamentit u zgjodh Ahmet Vefik pasha. Parlamenti përbehej nga dy dhoma: Dhoma e Deputetëve (Melis-i mebusan) dhe Dhoma e të Shquarve (Meclis-i ayan). Punimet në parlament filluan më 19 mars 1877. Mirëpo, fushata ushtarake e Ruisë (1877-1878) ndaj territoreve osmane në Ballkan bëri që Sulltani më 13 shkurt 1878 të kërkojë mbylljen e punimeve të parlamentit për një afat të pacaktuar. Kryengritjet e vazhdueshme në territoret osmane obliguan Abdylhamitin II që më 24 korrik 1908 të rishpallte kushtetutën e 1876-ës. Pas zgjedhjeve të përgjithshme, më 17 dhjetor 1908 u mblodh parlamenti i dytë osman, i cili vazhdoi aktivitetin e tij deri me 1920. Angazhim në seanca parlamentare treguan edhe deputetët shqiptarë, të cilët me fjalimet e tyre kritikonin politikën qeverisëse, duke kërkuar zgjerimin e të drejtave në fushën e arsimit, gjendjes së rëndë ekonomike etj. Shqiptarët përfaqësoshin nga deputetët e deleguar nga zonat e ndryshme, siç ishin: Nexhip Draga (Shkup), Hasan Prishtina, Hysejn Fuat pasha, Mustafa Hamdi efendiu (Prishtinë), Mehmed Emin efendiu, Sherf Bej, Vehbi Efendiu, Jahja Beu (Prizren) Basri Beu, Ismail Beu, Shevket Beu (Dibër), Shahin Naki efendiu (Korçë), Aziz Pasha, Ismail Kemal beu (Berat) etj. (Agron Islami)

PAROVIQ-PESHIKAN (Parović-Pešikan) Maja (1932-2008). Arkeologe serbe. Lindi në Moskë, ku diplomoi në Universitetin “Lomonosov” (1954). Në vitet 1954-1957 specializoi arkeologjinë antike në Institutin për Arkeologji të Akademisë së Shkencave në Kiev (Ukrainë). Doktoroi më 1960 në Beograd. Nga viti 1959, deri në pensionim, punoi në Institutin Arkeologjik të Beogradit. Iu kushtua studimeve që lidhen me ndikimin grek dhe ndërhyrjen e kulturës greke në Ballkan, posaçërisht nga aspekti i studimit të qeramikës së importuar greke, kulturës materiale ilire deri te romanizimi i saj etj. Udhëhoqi hulumtime arkeologjike, nga të cilat veçohen ato në Sirmium (1969-1970), të tumave ilire, kalave dhe vendbanimeve antike në Bokën e Kotorrit (1965-1973) dhe ato në Ulpianë (1982-1989). Ishte sekretare e Këshillit Ndërkademiq të “Corpus Vasorum Antiquorum”. Publikoi

një sërë punimesh shkencore, disa libra dhe ishte pjesëmarrëse e shumë konferencave ndërkombëtare. (Premtim Alaj)

PARTESHI. Fshat dhe qendër e komunës me të njëjtin emër. Është vendbanim i tipit të grumbulluar, 7 km në perëndim të Gjilanit, në lartësi mbidetare 495 m. Shtrihet në të dy



PARTESHI

anët e rrugës Gjilan-Ferizaj, me sipërfaqe prej 806 ha, nga e cila 55% janë ara, 33% kulloja, 7% pyje e shkurre dhe 5% hapësirë e ndërtuar. Me projektin e decentralizimit të vitit 2007 u shpall qendër komunale, në kuadër të së cilës përfshihen vendbanimet Budrigë e Poshtme dhe Pasion. Gjurmët arkeologjike dëshmojnë për vazhdimësinë e këtij vendbanimi që nga antika dhe mesjeta. Në defterët kadastralë të vilajetit Vëllk të vitit 1445 përmendet me emrin Parish me 17 shtëpi. Rreth 250 vjet më parë, ky vendbanim ishte i banuar me shqiptarë, mirëpo ata ishin ndërruar me disa familje serbe të Zhegovcit, për t'u shmangur detyrimeve ndaj çifligarëve të pushtetit osman. Disa familje të mbetura aty u shpërngulën pas vitit 1912. Sot Parteshi është i banuar me popullsi serbe. Popullsia merret me kultivimin e drithërave, pemëve dhe perimeve. Si qendër komunale, tani këtu janë vendosur objektet administrative, financiare, arsimore, shëndetësore dhe fetare. Në vitin 2011 kishte 478 banorë, ndaj 355 në vitin 1921. (Përparim Gashi)

PARTESHI (komuna). Komunë në pjesën lindore të Kosovës, me vendbanimin qendror me të njëjtin emër. Shtrihet në anën e majtë të lumit Morava e Binçës, në lartësi mbidetare 500 m, në të dy anët e magjistrales Gjilan-Ferizaj. Zë sipërfaqen prej 2,963 ha, nga e

cila 48% janë ara, 28% pyje, 20% kulloja dhe 4% zonë e ndërtuar. Në pjesën perëndimore kufizohet me komunën e Vitisë, ndërsa në të gjitha anët e tjera rrethohet nga komuna e Gjilanit. Deri në vitin 2007, Parteshi ishte vetëm një fshat i komunës së Gjilanit, por me projektin e Ahtisarit bëhet komunë, duke shkëputur nga komuna e Gjilanit vendbanimet Pasion dhe Budrigë, të banuara me serbë. Pjesa më e madhe e territorit i takon fushës së Anamoravës me reliev fushor dhe toka të punueshme, ndërsa në pjesën lindore fillon të ngrihet relievi kodrinor-malor i Karadakut. Mbizotëron klima e mesme kontinentale, me temperaturë mesatare 10.5 °C, kurse mesatarja vjetore e reshjeve është 550 mm/vit. Lumi kryesor është Morava e Binçës me degët e saj: Livoçin, Çegranin dhe Cërrnicën. Popullsia kryesisht merret me kultivimin e grurit, misrit dhe patates. Në vitin 2011 kishte 1,787 banorë, ndaj 2,717 banorëve në vitin 1948. (Përparim Gashi)

PARTIA "XHEMIJETI" (BASHKIMI). Parti politike e shqiptarëve dhe e myslimanëve në Mbretërinë e Jugosllavisë. Emri i saj i plotë në turqisht ishte: "Islam Muhafaza-yl Hukuk Cemijet" (Shoqatë Islamike për Mbrojtje dhe Drejtësi). U themelua më 18 dhjetor 1919 në Shkup. Ishte menduar si parti që do të bashkonte myslimanët e Bosnjës, të Kosovës dhe të Maqedonisë, por kjo nuk u arrit për shkak të dallimeve gjuhësore. Megjithatë, në kongresin themelues në Shkup u ra dakord që në programin e "Xhimijetit" të përfshiheshin disa synime të përbashkëta të të gjithë myslimanëve të Mbretërisë Jugosllave, siç ishte autonomia e plotë fetare, vazhdimësia e gjyqeve të Sheriatit për çështjet civile, ruajtja e vakëfeve, "përdorimi i lirë dhe zyrtar i gjuhës përkatëse amtare të joserbëve në shkolla" dhe mbrojtjen e pronave të bejlerëve nga reformat e reja agrare. Në kongresin themelues në Shkup kryetar i "Xhemijetit" u zgjodh Nexhip Draga, nënkryetar sheh Sadudini dhe sekretar Aqif Blyta. Në radhët e shqiptarëve partia u njoh shpejt si organizatë për mbrojtjen e të drejtave të tyre, ndërsa për Mbretërinë Serbe-Kroate-Slllovene (SKS) njihej si organizatë e "myslimanëve të Jugut", ose "parti e beglerëve". Pas zgjedhjes së Ferat Dragës, që zëvendësoi Nexhip Dragën pas kongresit të dytë (1921), pozicioni i "Xhemijetit" u bë më i qartë: doli publikisht me

platformë kundër shpërnguljes së shqiptarëve në Turqi dhe denoncoi paseshtur dhunën dhe padrejtësitë e pushtetit ndaj shqiptarëve. Por, në anën tjetër, “Xhemijeti” votoi Kushtetutën e Vidovdanit, duke bërë gabimin më të madh strategjik. Në zgjedhjet parlamentare më 1920 zuri 8 vende, ndërsa më 1923 arriti suksesin më të madh, duke marrë 14 vende në Kuvendin e Mbretërisë së SKS-së. Por marrëveshja që bënte me Nikolla Pashqin nuk solli ndonjë rezultat, sepse kërkesa e “Xhemijetit” për hapjen e shkollave shqipe nuk u përfill nga radikalët serbë. Më 1925 “Xhemijeti” nuk votoi buxhetin dhe doli në opozitë. Një fraksion i partisë nuk e përkrahu Ferhat Dragën dhe në parti filloi përcarja. Më 1925 Ferhat Draga u burgos, u dënua më 20 vjet burg, më pas u lirua dhe u ftua në Beograd për bisedime, u burgos sërish dhe sërish u dënua me 20 vjet burg. Ndërkohë, “Xhemijeti” zyrtarisht u ndalua në shkurt të vitit 1925. Për disa vjet me radhë “Xhemijeti” botoi revsitën “Hak” (E drejta), që dilte në gjuhën turke me shkronja arabe, me një shtojcë javore në gjuhën serbe. Gazetën e drejtonte Asim Salihamixhiqi nga Sanxhaku. Në faqet e saj u publikuan të dhëna tronditëse për reprezaljet dhe dhunën ndaj shqiptarëve, për shpërnguljet etj. Gazeta u ndalua më 1925, atëherë kur u ndalua edhe partia. (Hakif Bajrami)

PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS (PDK). Parti politike e themeluar më 1999, në fillim me emrin Partia e Progresit Demokratik të Kosovës (PPDK). Si datë e themelimit të kësaj partie konsiderohet 10 tetori 1999, kur u themelua Këshilli Organizativ i PPDK-së. Pjesa dërrmuese e nismëtarëve për themelimin e Partisë përbëhej nga ish-udhëheqës të lartë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), përkatësisht të Drejtorisë Politike të UÇK-së. Në maj të vitit 2000, në kuvendin e parë zgjedhor, partia ndryshon emrin dhe u bë Partia Demokratike e Kosovës (PDK). Që nga themelimi i saj, PDK-ja udhëhiqet nga Hashim Thaçi, i konfirmuar si kryetar në kuvendet zgjedhore në maj 2000, qershor 2002, tetor 2005 dhe janar 2013. Në zgjedhjet e para komunale PDK-ja fitoi 27.3% të votave në nivel të Kosovës, duke u radhitur e para në 5 komuna, ndërkaq në të gjitha komunat kishte 267 këshilltarë komunalë. Në zgjedhjet e para parlamentare fitoi 25.7% të votave në nivel të Kosovës dhe ishte subjekti i dytë politik për

kah numri i deputetëve (26) në Kuvendin e Kosovës, pas Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK). Që nga zgjedhjet e vitit 2007, PDK-ja arriti të radhitet si forca e parë parlamentare me 37 deputetë. Në zgjedhjet e vitit 2010, PDK-ja vazhdoi të jetë forca e parë në Kuvend me 34 deputetë. Pas zgjedhjeve të vitit 2014, PDK-ja në koalicion me grup partish të tjera (Lëvizja për Bashkim, Partia e Drejtësisë, Partia Shqiptare Demokristiane e Kosovës) arriti të ruante primatin parlamentar me 37 deputetë. Që nga kuvendi i vitit 2013, PDK-ja u profilizua si parti e qendrës së djathtë. Në nivelin qendror të pushtetit, PDK-ja ka qenë në krye të Qeverisë në disa mandate. Pas zgjedhjeve të para në nivel të vendit, PDK-ja ka udhëhequr Qeverinë përmes kryeministrit Bajram Rexhepi, ndërsa që nga viti 2007 deri më 2014 Qeveria është kryesuar nga kryeministri Hashim Thaçi. Pas zgjedhjeve të qershorit 2014 dhe marrëveshjes së nëntorit 2014 me LDK-në, dy partitë më të mëdha bashkëqeverisin, ndërsa kryetari i PDK-së mbajti postin e zëvendëskryeministrit të parë dhe atë të ministrit të Punëve të Jashtme. Në mars të vitit 2016 kryetari i PDK-së, Hashim Thaçi, u kandidua për president të Kosovës, prandaj dha dorëheqje dhe drejtimin e partisë e mori Kadri Veseli. Ndërkaq, dy nga themeluesit e Partisë, Jakup Krasniqi dhe Fatmir Limaj, pas një kohe të gjatë të mospajtimeve me kreun e partisë, në shkurt të vitit 2014 braktisën PDK-në dhe themeluan partinë e re, “Nisma për Kosovën”. (Iilir Dugolli)

PARTIA DEMOKRATIKE POPULLORE (PDP). Partia e dytë shqiptare në Maqedoni, e themeluar më 23 qershor 1990 në Tetovë. Në Kuvendin themelues për kryetar u zgjodh Jusuf Rexhepi, ndërsa nënkryetar Ramadan Sinani. Kreu i kësaj partie bëri përpjekje për unifikimin e faktorit politik shqiptar në Maqedoni, por një gjë e tillë nuk ndodhi, pasi Partia e Prosperitetit Demokratik (PPD) taktizoi me bashkimin e dy subjekteve, për çka kryesia e PDP-së dha dorëheqje. Më pas në krye të PDP-së erdh Iljaz Halimi. Në zgjedhjet e para parlamentare PDP-ja mori pjesë në koalicion me PPD-në. Por PDP-ja ndoqi një kurs më të ashpër ndaj shtetit maqedonas, kështu që ajo bojkotoi regjistrimin e popullsisë në 1991 dhe referendumin për të ardhmen e Maqedonisë. PDP-ja mbështeti referendumin për autonomi politiko-territoriale të shqiptarëve të Maqedonisë, që u mbajt

më 11 dhe 12 janar 1992. Ndërkohë, nga i ashtuquajtimi kongres i bashkimit mes PPD-së dhe PDP-së, që u mbajt në vitin 1997, lindi Partia Demokratike Shqiptare, ndërsa kryetari i PDP-së, Iljaz Halimi, u zgjodh nënkryetar i partisë së re. (Arsim Sinani)

PARTIA DEMOKRATIKE SHQIPTARE (PDSH). Parti politike e shqiptarëve në Maqedoni, e krijuar në vitin 1994, pas ndarjes së Partisë për Prosperitet Demokratik (PPD). Në Kongresin e jashtëzakonshëm, kryetar i PPD-së u zgjodh Arbën Xhaferi, i cili regjistroi partinë me emrin e ri Partia për Prosperitet Demokratik të Shqiptarëve (PPDSH). Në vitin 1996, kjo parti fitoi në komunat kryesore, atë të Gostivarit me Rufi Osmanin dhe në Tetovë, me Alajdin Demirin, të cilët bashkë me kryesuesit e këshillave të komunës Gostivar dhe Tetovë, Refik Dautin dhe Vebi Bexhetin ishin burgosur dhe dënuar me burg për shkak të ngritjes së flamurit shqiptar. Më 5-7 korrik 1997, pas shkrirjes me Partinë Demokratike Popullore (PDP), partia e re u quajt Partia Demokratike Shqiptare (PDSH). Në vitin 1998, pas zgjedhjeve parlamentare në Maqedoni, PDSH-ja hyri në koalicion me VMRO-DPMNE-në e Lubço Georgievskit dhe menaxhoi me sukses fluksin e madh të shqiptarëve gjatë luftës së Kosovës (1999). Kreu i kësaj partie, Arbën Xhaferi, ishte njëri nga nënshkruesit e Marrëveshjes së Ohrit, që ndali luftën në Maqedoni në vitin 2001. Pas tërheqjes së Arbën Xhaferit nga politika, kryetar i kësaj partie u zgjodh Menduh Thaçi. Në vitin 2006-2008, pas zgjedhjeve parlamentare, PDSH-ja hyri në koalicion me VMRO-DPMNE-në e Nikolla Gruevskit. Më pas PDSH-ja ishte parti opozitare në Kuvendin e Maqedonisë. (Arsim Sinani)

PARTIA E DREJTËSISË (PD). Parti politike në Kosovë, e themeluar në shtator të vitit 1999. PD-ja mbështetet në konceptin e respektimit të plotë të lirive dhe të drejtave të njeriut, përfshirë edhe ato fetare. Gjatë 15 vjetëve të aktivitetit, në katër prej pesë legjislativave ishte parti parlamentare e Kuvendit të Kosovës, ndërkaq si pjesë e koalicionit qeveritar pas zgjedhjeve 2010 udhëhoqi Ministrinë e Shëndetësisë. Në zgjedhjet lokale 2013, PD-ja siguroi 24 poste asamblistësh në 14 komuna të Kosovës, ndërsa pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 2014 siguroi dy poste të deputetëve në Kuvendin e

Kosovës dhe mori pjesë në Qeverinë e Kosovës me Ministrinë e Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor. Kryetar i PD-së në periudhën 1999-2008 ishte Sylejman Çerkez, ndërkaq nga viti 2008 kryetar është Ferid Agani. (Nerxhivane G. Dauti.)

PARTIA FASHISTE SHQIPTARE (1939). Organizim politik që përhapte ideologjinë fashiste dhe mbështeste pushtimin fashist të Shqipërisë dhe të Kosovës. Propaganda fashiste përhapej edhe në Kosovë që nga pushtimi i Shqipërisë më 1939, por u intensifikua pas bashkimit të Kosovës me Shqipërinë më 1941. Rol të rëndësishëm në përhapjen e ideologjisë fashiste ndër shqiptarët luajti Partia Fashiste Shqiptare (PFSH), e cila u themelua në qershor të vitit 1939. PFSH-ja, sipas statutit, ishte degë e Partisë Fashiste Italiane (PFI) dhe sekretarin e PFSH-së e emëronte dhe i shkarkonte mëkëmbësi i mbretit. Bashkë me mëkëmbësin punonin instruktorët e PFI-së, të cilët i përgjigjeshin drejtpërdrejt Musolinit. Në prefekturat e “Tokave të lirueme” u formuan katër federata të PFSH-së: në Prizren, Prishtinë, Pejë dhe Dibër. Në krye të federatës ishte federali, i zgjedhur nga vendësit, i cili gëzonte besimin e pushtetit italian. Inspektor i federatës emërohej një fashist italian, i cili kontrollonte dhe udhëhiqte tërë aktivitetin. Secila federatë kishte nga 12 seksione, ndër të cilat dalloheshin seksioni politik, ekonomik, seksioni për tregti, për arsim e kulturë, për financa dhe bujqësi etj. Seksioni politik, bashkë me inspektorin, udhëhiqte shërbimin informativ. Seksioni ekonomik kujdesej për shfrytëzimin e begatave natyrore dhe të fuqisë punuese, sidomos vëzhgonte dendësinë e popullsisë, sepse Italia pretendonte të kolonizonte Kosovën me qindra mijë italianë. Instanca më të ulëta se federate ishin fashjot e komunave, kurse në fshatra ishin bërthamat e eprorëve. Fashjot ekzistonin vetëm në disa komuna, kurse bërthamat e eprorëve vetëm në disa fshatra. Fashistët përpiqeshin të përfshinin tërë brezin e ri në organizatat e tyre, si: balilat, fëmijët nga 6-14 vjeç, me uniformë, pantallona të shkurtër dhe këmbë të zeza; avangardistët, rinia prej 14-17 vjeç, që vishnin pantallona të gjata gri, këmbë të zeza, kollare dhe kapela dhe “giovani fashista”, që ishin të rinjtë nga 17-21 vjeç. Të rinjtë në këtë organizatë konsideroheshin kontigjent që kishin përfaquar ideologjinë fashiste. Uniforma e tyre ishte e

ngjashme me atë të trupave ushtarake fashiste, ndërsa në xhakët mbanin të ngjitur Sëpatën e Liktorit. Me gjithë propagandën e fuqishme, në PFSH u anëtarësuan pak njerëz, kryesisht të punësuarit në administratën shtetërore, pastaj disa tregtarë dhe feudalë, të cilët synonin t'i ruanin privilegjet e tyre. (Fehmi Rexhepi)

PARTIA FSHATARE E KOSOVËS (PFK). Ishte ndër të parat parti postkomuniste në Kosovën e viteve nëntëdhjetë të shekullit XX. PFK-ja u themelua në vitin 1990, në kohën kur u krijuan edhe partitë e para politike të shqiptarëve në Kosovë. Ajo udhëhiqej nga Hivzi Islami, i cili e drejtoi partinë gjatë periudhës 1990-1995. Në fund të viteve '90 PFK-ja iu bashkua Këshillit Koordinues të Partive Politike, për të ritheksuar përkushtimin e tyre ndaj rezistencës paqësore. Ky Këshill kishte si synim bashkërendimin e ndihmave dhe rritjen e legjitimitetit të partive që e përbënin atë. (Qerim Qerimi)

PARTIA KOMUNISTE E JUGOSLLAVISË (PKJ). Organizatë e komunistëve jugosllavë, e themeluar më 1919, me bashkimin e pjesëve të partive socialdemokrate në shtetin e sapoformuar të Jugosllavisë. Të "majtët" e socialdemokratëve u ndanë nga qendra dhe formuan Partinë Komuniste të Jugosllavisë (Socialiste), si sesion i Internacionales Komuniste - Kominternit. Të bashkuar si "Jugosllavi" morën pjesë në zgjedhjet e nëntorit të vitit 1920 për Asamblenë Kushtetuese dhe kishin simpatizantët e vet në shumë qendra të mëdha. Një vit më vonë u ndalua me ligj aktiviteti politik i PKJ-së. Në ilegalitet nuk arriti ta ruante fuqinë e vet politike. Udhëheqësit e saj nuk kishin qëndrime të koordinuara dhe as strategji veprimi lidhur me kërkesat e kohës. Në udhëheqjen e PKJ-së, deri në vitin 1936, lindën fraksione të ndryshme, ndaj u ndërrua shpesh edhe kreu i partisë. Me ardhjen e Josip Broz Titos në krye të Partisë (më 1937), u forcua centralizmi partiak dhe ideologjia kominterniste. Programi politik i PKJ-së "Barazia e popujve dhe liria nacionale për të gjithë", fitoi simpatinë e popujve të përfshirë në Jugosllavinë monarkiste, përfshirë edhe shqiptarët. Udhëheqësit e PKJ-së propagandonin se Jugosllavia e Versajës ishte në konflikt me të gjithë fqinjët dhe se ajo shkonte dita-ditës në konflikt lufte veçmas rreth Shqipërisë. PKJ përshëndeti luftën e drejtë kombëtare të shqip-

tarëve dhe çështjen e shkatërrimit të Mbretërisë Serbe-Kroate-Slllovene e shtronte si të domosdoshme. Të nxitur nga parimet programore të PKJ-së, populli shqiptar i Kosovës në fillim shfaqti simpati të rezervuar ndaj këtij organizimi politik, duke ia lënë kohës të vërtetojë në praktikë atë që deklarohet me fjalë. Por PKJ shpejt u bë mbrojtëse fanatike e integritetit të shtetit jugosllav dhe e pansllavizmit, duke i ndëshkuar shqiptarët e Kosovës më shumë nga të gjithë për nacionalizëm dhe irredentizëm. (Daut Bislimi)

PARTIA NACIONAL-DEMOKRATE SHQIPTARE (PNDSH). U themelua më 3 maj të vitit 1992 në Prishtinë. Origjina e saj daton që nga koha e Lëvizjes Nacional-Demokratike Shqiptare (LNDSH), e cila ishte aktive gjatë viteve 1945-1947. PNDSH-ja përqafon vlerat properëndimore dhe liberale, si dhe ka qëndrim të qartë kundër komunizmit, terrorizmit dhe racizmit. Në programin e saj kjo parti konsideron se ruajtja e vlerave të kulturës, traditës dhe familjes janë baza të një shoqërie liberal-demokrate, gjë që e vendos këtë parti në krahun e djathtë të spektrit politik. Nga themelimi deri në vitin 2007, kryetar i PNDSH-së ishte Rexhep Abdullahu. (Qerim Qerimi)

PARTIA PËR BASHKIM DEMOKRATIK (PBD). U krijua më 4 korrik të vitit 1999 nga një grup i ish-anëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Moto e tyre ishte: "Mendo për të ardhmen, mos e harro luftën". Në takimin hapës, Bardhyl Mahmuti, përfaqësues i UÇK-së në Zvicër, u zgjodh kryetar, Jakup Krasniqi dhe Martin Berishaj nënkryetarë dhe një Këshill 51-anëtarësh, pa ish-udhëheqësin e Drejtorisë Politike të UÇK-së, Hashim Thaçin. Disa muaj më vonë udhëheqësit e PBD-së arritën marrëveshje me Thaçin dhe më 10 tetor 1999 së bashku formuan Partinë për Progres Demokratik në Kosovë (PPDK). PPDK-ja mbajti këtë emër deri në kongresin e parë të partisë, i cili u mbajt në qershor të vitit 2000, kur mori emrin Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dhe Hashim Thaçi u zgjodh kryetar i partisë. (Qerim Qerimi)

PARTIA PËR PROSPERITET DEMOKRATIK (PPD). Partia e parë politike shqiptare postkomuniste në Maqedoni. U themelua më 16 prill 1990 në fshatin Xhepçishtë të Tetovës,

me kryetar Nevzat Halilin. Për një kohë ishte partia shqiptare me më shumë peshë në skenën politike të Maqedonisë. Në zgjedhjet e para pluraliste në Maqedoni, PPD-ja fitoi 22 deputetë në Parlamentin e Maqedonisë dhe bëhet partia më e madhe shqiptare në Maqedoni. Pas zgjedhjeve hyn në koalicion më Lidhjen Socialdemokrate të Maqedonisë (LSDM) dhe deri në vitin 1998 merr pjesë në Qeveritë e Republikës së Maqedonisë, si forca kryesore politike shqiptare. Në kongresin e jashtëzakonshëm në vitin 1994, partia ndahet në dysh, prej nga dalin dy kryesi, njëra me Arbën Xhaferin, tjetra me Xheladin Muratin. Organet shtetërore legjitimitetin ia njohin krahut të Xheladin Muratit, ndërsa për kryetar të saj zgjidhet Abdurrahman Aliti. Në periudhën e luftës mes njërive të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare dhe forcave policore dhe ushtarake maqedonase, kryetari i kësaj partie, Imer Imeri, mori pjesë në bisedimet që pasuan me nënshkrimin e Marrëveshjes së Ohrit, si njëri nga dy nënshkruesit shqiptarë të kësaj marrëveshjeje. Pas luftës së vitit 2001, partia humb peshën politike. Edhe sot PPD-ja është aktive, por nuk ka asnjë deputet në Parlamentin e Maqedonisë. (Arsim Sinani)

PARTIA PËR VEPRIM DEMOKARTIK (PVD). Parti politike e shqiptarëve në Serbi, e themeluar në Preshevë në vitin 1990. Pas themelimit të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) dhe të partive të tjera politike në Kosovë, shqiptarët e Luginës së Preshevës më 1990 filluan gjithashtu organizimin e tyre politik pluralist. Më 19 gusht të vitit 1990, në sallën e Shtëpisë së Kulturës “Abdullah Krashnica” në Preshevë u mbajt kuvendi themelues i Partisë për Veprim Demokratik (PVD). Kryesia e partisë zgjodhi edhe organet udhëheqëse të saj. Anëtarë të kryesisë u zgjodhën: Riza Halimi (kryetar), Havçe Hasani, Nexhat Sadullahu, Kadri Ferati (nënkryetarë) dhe Rexhep Hasani (sekretar i përgjithshëm). Që nga themelimi, pozitën e kryetarit të PVD-së e mban Riza Halimi. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2014 PVD-ja fitoi dy vende në Kuvendin e Serbisë. (Qerim Qerimi)

PARTIA POLITIKE “NISMA PËR KOSOVËN”. Parti politike e themeluar më 27 shkurt 2014, me kryetar Fatmir Limajn. Partia përbëhet nga Këshilli Kombëtar dhe Këshilli Drejtues.

Kryetar i Këshillit Drejtues është Fatmir Limaj, ndërsa Kryetar i Këshillit Kombëtar, Jakup Krasniqi. Fryma demokratike, zhvillimi ekonomik, ulja e papunësisë dhe mirëqenia e qytetarëve të Kosovës janë pikat kryesore në programin e saj. Pas zgjedhjeve të qershorit të vitit 2014, “Nisma” përfaqësohet në Kuvendin e Republikës së Kosovës me gjashtë deputetë. (Nerxhivane G. Dauti)

PARTIA POLITIKE “UNIKOMB”. Parti politike e Kosovës. Partia e Unitetit Kombëtar (UNIKOMB) u themelua më 5 maj të vitit 1991 nga Halil Alidemaj. Në vitin 1994 Ukshin Hoti u bë udhëheqës i UNIKOMB-it dhe më pastaj u burgos. Partia hyri në koalicion me Lëvizjen e Bashkuar Demokratike (LBD) të Rexhep Qosjes në vitin 1998. Gjatë luftës, Ukshin Hoti u zhduk dhe besohet të jetë vrarë. Muhamet Kelmendi drejtoi partinë që nga viti 2000 e deri në vitin 2004. Në zgjedhjet lokale të vitit 2000 dhe ato parlamentare të vitit 2001, UNIKOMB-i garoi si pjesë e koalicionit parazgjedhor me AAK-në. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2001, Muhamet Kelmendi fitoi një ulëse në Parlament. Partia u shpërnda në vitin 2004. (Qerim Qerimi).

PARTIA SOCIALDEMOKRATE E KOSOVËS (PSDK). Parti politike e themeluar më 10 shtator 1990, si parti e qendrës së majtë. Fillimisht është udhëhequr nga Muhamedin Kullashi, më pas nga Shkëlzen Maliqi, Luljeta Pula-Beqiri dhe Kaqusha Jashari. Në fund të vitit 2008, Agim Çeku i është bashkuar PSDK-së dhe është zgjedhur unanimisht kryetar i partisë, për ta braktisur atë në fillim të vitit 2013. Pas paraqitjes në skenë të dy rrymave kryesore dhe një periudhe të shkurtër me dy pretendente për kreun e partisë (Kaçusha Jashari dhe Majlinda Nushi), Kaçusha Jashari ka arritur që të rikthehet si kryetar, post që vazhdon ta mbajë. Gjatë viteve nëntëdhjetë PSDK-ja ka qenë pjesëmarrëse e zgjedhjeve parlamentare. Gjatë kësaj periudhe të rezistencës paqësore në pikat qenësore të orientimit strategjik ka mbajtur qëndrime identike me Lidhjen Demokratike të Kosovës. Në vitin 2007 PSDK-ja ka lidhur koalicion parazgjedhor me Partinë Demokratike (PDK) të Kosovës dhe ka udhëhequr Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës, përmes kryetarit të saj Agim Çeku. Së fundi, partia udhëhiqet nga Kaqusha Jashari

dhe nuk është e përfaqësuar në Kuvendin e Kosovës. (Irir Dugolli)

PARTIA SHQIPTARE DEMOKRISTIANE E KOSOVËS (PSHDK). Parti politike e themeluar më 4 nëntor 1990 në Gjakovë me kryetarin e parë Lazër Krasniqin, më vonë me Mark Krasniqin, Zef Morinën, Marjan Demën dhe Ukë Berishën. Për kah profili ideologjik PSHDK-ja deklarohet si parti e qendrës së djathtë. Gjatë viteve nëntëdhjetë, në orientimet themelore rreth rezistencës paqësore dhe të vizionit për Kosovën ka mbajtur qëndrime identike me Lidhjen Demokratike të Kosovë (LDK). Ishte pjesëmarrëse e zgjedhjeve në vitin 1992, pas të cilave kishte gjashtë deputetë dhe në ato të vitit 1998, kur kishte 12 deputetë në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Pas çlirimit të vendit ka qenë pjesë e koalicioneve të ndryshme, fillimisht në zgjedhjet e vitit 2001 me LDK-në, e më pas me PDK-në. Në qeverinë e parë të pasluftës, 2002-2004, u përfaqësua me kryetarin e saj Zef Morina. Pas zgjedhjeve të vitit 2012, në të cilat garoi si pjesë e koalicionit me PDK-në, PSHDK-ja nuk arriti të përfaqësohet në Kuvend. Nga fundi i vitit 2004 dolën në sipërfaqe dallime të thella të partisë dhe kontestime të procesit të brendshëm zgjedhor. Si pasojë e mospajtimeve, partia ndahet në dysh, në PSHDK udhëhequr nga Ton Marku dhe PDI-ja (Partia Demokratike për Integritim) e udhëhequr nga Zef Morina. Këto dy parti u ribashkuan në PSHDK në vitin 2009. Në kuvendin e jashtëzakonshëm të partisë në vitin 2010 për kryetar u zgjodh Marjan Dema, ndërsa që nga viti 2012 në krye të partisë është Ukë Berisha. (Irir Dugolli)

PARTITË LOKALE NË LUGINËN E PRESHEVËS. Janë parti, të cilat kanë shtrirje vetëm në ndonjërin nga komunat e Luginës së Preshevës. Lëvizja e Progresit Demokratik (LPD) u themelua si parti politike e dalë nga ish-strukturat politiko-ushtarake të UÇPMB-së. Kryetar i LPD-së është Jonuz Musliu. Veprimtaria e LPD-së është e shtrirë vetëm në komunën e Bujanocit. Partia tjetër, Bashkimi Demokratik i Luginës (BDL) u themelua nga një numër i anëtarëve të mëhershëm të Partisë për Veprim Demokratik. Kryetar i BDL-së është Skënder Destani, i cili ka qenë për shumë vjet anëtar i kryesisë së PVD-së. BDL-ja ka qenë disa herë pjesë e pushtetit lokal, ndërsa Destani

ishte nënkryetar i komunës së Preshevës. BDL-ja ka shtrirje vetëm në komunën e Preshevës. (Qerim Qerimi)

PARTITË POLITIKE NË KOSOVË. Grupimet e para të partive politike në Kosovë i gjejmë që në vitet 1875-1876, të cilat ishin aktive veçmas në periudhën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (1878). Në fillim të shekullit XX, ndër të parat organizma kombëtarë me synime politike ishte “Klubi Bashkimi”, i cili veproi në vitet 1908-1912, me aktivitetin e tij kryesisht arsimor, kulturor e politik. Më vonë, deri në vitin 1912, shqiptarët organizoheshin në parti politike të përfaqësuar qoftë në Parlamentin e Perandorisë Otomane, apo në Kuvendin e Mbretërisë së Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve. Në periudhën midis dy luftërave botërore, në Shkodër u themelua “Komiteti Kosova” (1918). Ndërkaq, në Shkup, në vitin 1919 u formua Partia “Xhimijet”, me lider të saj Nexhib Dragën, ndërsa pas vdekjes së tij në vitin 1921 e zëvendësoi Ferhat Draga. Menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore, në shkurt të vitit 1945, u themelua partia e parë antikomuniste, Nacional-Demokratike Shqiptare (NDSH), e cila veproi në Kosovë, në Maqedoni dhe në disa vende të Shqipërisë, me kryetar Gjon Sereqin. Regjimi komunist e ndaloi NDSH-në, anëtarët i burgosi, kurse liderin e saj e pushkatoi.

Gjatë periudhës së komunizmit, e vetmja parti e lejuar në Kosovë ishte Partia Komuniste e Jugosllavisë, përkatësisht Lidhja Komuniste e Jugosllavisë (LKJ). Por, ndërkohë, në Kosovë u formuan dhe funksionuan ilegalisht disa grupime politike me profilizim ideologjik të majtë, kryesisht nën ndikimin e Partisë së Punës së Shqipërisë, por me orientim dhe program kombëtar, të cilat synim kryesor e kishin çlirimin e Kosovës nga Jugosllavia dhe bashkimin e saj me Shqipërinë. Disa nga këto grupime politike ilegale arritën të bënin anëtarësi të gjerë dhe të organizoheshin si parti politike. Ndër to më e njohura ishte Lëvizja Popullore për Republikën e Kosovës (LPRK), e themeluar në vitin 1982, e cila veproi ilegalisht deri në luftën e vitit 1999, duke u bërë organizatorja kryesore e luftës së armatosur në Kosovë. Pas luftës, LPRK-ja dhe anëtarësia e saj kaloi nëpër fazat e legalizimit, të profilizimit dhe të riemërimit (Lëvizja Popullore e Kosovës, LPK). Në tetor të vitit 1999, LPK-ja u shndërrua nga lëvizja në parti politike

dhe fillimisht mori emrin Partia e Progresit Demokratik të Kosovës (më pastaj u riemërua Partia Demokratike e Kosovës). Një tjetër parti në ilegalitet ishte edhe Lëvizja Kombëtare për Çlirimin e Kosovës (LKÇK), e themeluar në vitin në vitin 1993, e njohur gjithashtu për mbështetjen e rezistencës së armatosur në Kosovë dhe kritikës së vazhdueshme të rezistencës paqësore. Pas çlirimit të Kosovës është rreshtuar në kuadër të koalicionit me Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe u nda në dy parti të ndryshme, Lëvizja për Integrim dhe Bashkim (LIB) e udhëhequr nga Smajl Latifi dhe më pas nga Fadil Fazliu, si dhe Lëvizja për Bashkim (LB), e udhëhequr nga Avni Klinaku. Në maj të vitit 2011 të dy fraksionet u shkrin në Lëvizja për Bashkim.

Në fillim të viteve '90 të shekullit të kaluar paraqiten partitë e para politike, si pasojë e rënies së komunizmit dhe suprimimit të autonomisë së Kosovës. Më 23 dhjetor 1989, në Kosovë formohet partia e parë politike postkomuniste, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK). Që nga themelimi e deri në janar 2006, kryetar i LDK-së ishte Ibrahim Rugova, pas tij kryetar i partisë u zgjodh Fatmir Sejdiu (2007-2011), ndërkaq nga viti 2011 e deri më sot kryetar i LDK-së është Isa Mustafa. LDK-ja u profilizua si parti e qendrës së djathtë, disa herë përjetoi tronditje të brendshme dhe u ballafaqua edhe me humbje të primatit të partisë kryesore parlamentare në Kosovë. Për shkak të këmbënguljes në opsionin paqësor edhe në rrethanat e pushtimit serb dhe të luftës në Kosovë, LDK-ja përjetoi tronditje dhe zvogëlim të ndjeshëm të anëtarësisë. Në vitin 1999 nga LDK-ja u nda një fraksion të pakënaqurish, të cilët u rigrupuan më 1999 në Lëvizjen Demokratike për Bashkim, në krye të së cilës u zgjodh Rexhep Qosja. Pasi nuk e kaloi pragun zgjedhor në zgjedhjet e para pas luftës në Kosovë, partia u shpërbë. Në vitin 2007 nga LDK-ja u nda një grup tjetër të pakënaqurish, në krye me Nexhat Dacin, të cilët themeluan Lidhjen Demokratike të Dardanisë (LDD). Pas rezultateve të arritura në garën e parë zgjedhore, së fundi LDD-ja nuk e kaloi pragun zgjedhor dhe u shpërbë. Ndër të parat parti politike në Kosovë në vitet '90 ishte edhe Partia Fshatare e Kosovës (PFK), e themeluar në vitin 1990 dhe e drejtuar nga Hivzi Islami, ndërsa Partia Socialdemokrate e Kosovës (PSDK) u themelua më 10 shtator 1990, fillimisht e

udhëhequr nga Muhamedin Kullashi dhe më pas nga Shkëlzen Maliqi, Luljeta Pula-Beqiri dhe Kaqusha Jashari, Agim Çeku dhe sërish nga Kaqusha Jashari. Po në vjeshtën e vitit 1990 u themelua në Gjakovë edhe Partia Shqiptare Demokristiane (PSHDK), me kryetarin e parë Lazër Krasniqin, më vonë me kryetar Mark Krasniqin, Zef Morinën, Marjan Demën dhe Ukë Berishën. Partia Demokratike e Kosovës (PDK) u themelua më 1999 si vazhdimësi e LPRK-LPK-së, me emrin Partia e Progresit Demokratik të Kosovës, ndërsa në maj të vitit 2000, në kuvendin e parë zgjedhor ndryshoi emrin në Partia Demokratike e Kosovës. Që nga themelimi e deri më 2016 u udhëhoq nga Hashim Thaçi, më pas nga Kadri Veseli. Në zgjedhjet e përgjithshme PDK-ja ka avancuar nga një legjislaturë në tjetrën, duke u bërë së fundi partia më e madhe në Kosovë. Edhe PDK-ja pati tronditje të brendshme: në shkurt të vitit 2014 nga PDK-ja u nda "Nisma për Kosovën", e cila i mori PDK-së një pjesë të anëtarësisë dhe u bë opozitë e saj. Ndërkohë, në periudhën e pasluftës në Kosovë u themeluan edhe parti të tjera. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), që u formua në vitin 2000, në fillim ishte koalicion grupimesh politike, pastaj u bë parti, e cila që nga fillimi udhëhiqet nga Ramush Haradinaj. Aleanca për Kosovën e Re (AKR) u themelua në vitin 2006 nga Behgjet Pacolli, i cili është edhe kryetar i saj. Alternativa Demokratike e Kosovës (ADK) u themelua në vitin 2004, me kryetaren Edita Tahiri. Iniciativa "Ora" u themelua në vitin 2004 nga publicisti Veton Surroi. Partia Liberale u themelua në vitin 1991 dhe për një kohë të gjatë u udhëhoq nga kryetari i saj, Gjergj Dedaj.

Sot në Republikën e Kosovës veprojnë 67 subjekte politike (parti politike, koalicione) dhe 3 iniciativa qytetare, që tashmë kanë përfaqësuesit e vet në Kuvendin e Kosovës. Prej tyre 21 janë shqiptare, 13 serbe, 3 turke, 8 boshnjake, 2 rome, 2 ashkali, 2 egjiptiane, 4 gorane, 1 gorane-boshnjake, 1 malazeze dhe 3 parti politike kroate. (Osman Ismaili).

PARTITË POLITIKE SHQIPTARE NË MAQEDONI. Pas Luftës së Dytë Botërore te shqiptarët e Maqedonisë veproji NDSH-ja antikomuniste, e cila u shua pas ndjekjes nga regjimi jugosllav dhe dënimit të krerëve të saj. Gjatë periudhës komuniste te shqiptarët e Maqedonisë veprojnë degët e lëvizjeve ilegale të

formuara në Kosovë. Pas rënies së komunizmit dhe në prag të pavarësimit të Maqedonisë, më 16 prill 1990 u formua Partia për Prosperitet Demokratik (PPD), si partia e parë politike shqiptare në Maqedoninë postkomuniste, me kryetar Nevzat Halilin. Partia tjetër shqiptare, Partia Demokratike Popullore (PDP), u formua më 23 qershor 1990, ndërsa kryetar i saj u zgjodh Jusuf Rexhepi, e më vonë Iljaz Halimi. Me përçarjen e subjektit më të madh politik, PPD-së, ajo u nda në dy pjesë dhe njëri krah vazhdoi me emrin e njëjtë dhe për kryetar pati Xheladin Muratin e më vonë Abdurrahman Alitin. Më vonë kryetar i saj ishte Imer Imeri, i cili ishte edhe nënshkrues i Marrëveshjes së Ohrit. Krahu tjetër vazhdoi me të njëjtin emër, derisa u riemërua si Partia e Prosperitet Demokratik të Shqiptarëve dhe për kryetar kishte Arbën Xhaferin. Më vonë kjo parti u bashkua me Partinë Demokratike Popullore dhe nga kjo lindi Partia Demokratike Shqiptare (PDSH). Së fundi drejtimin e partisë e mori Menduh Thaçi. Në këtë garë politike gjatë periudhës së viteve 1994-98 kanë lindur edhe disa parti të tjera shqiptare, si Partia Liberal-Demokrate Shqiptare (e udhëhequr nga Hisen Ramadani), Partia Republikane e Unitetit Popullor (me në krye Nevzat Halilin) dhe Partia e Aksionit Demokratik-Rruga Islame, në të cilën ishin tubuar kryesisht personalitete të sferës fetare. Pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 1998 skenës politike iu bashkëngjitën edhe parti të tjera politike: Alternativa Demokratike (me udhëheqës Asllan Selmanin), Partia për Bashkimin Demokratik Shqiptar (me kryetar Besnik Telai) dhe Partia Demokratike Kombëtare (PDK) (me kryetar Kastriot Haxhirexhën), e cila promovoi programin e saj politik për federalizimin e Maqedonisë. Edhe ish-kryetari i Tetovës, Alajdin Demiri, krijoi partinë e tij, Aleancën Demokratike, por pa ndonjë sukses. Më pas paraqitet edhe Alternativa Kombëtare (AK) e Harun Aliut. Një pjesë e aktivistëve të këtyre partive politike më parë kishin zhvilluar aktivitetin e tyre në ilegalitet. Nga Partia Demokratike Shqiptare u shkëput gjysma e deputetëve dhe prej tyre lindi Demokracia e Re (DR), e drejtuar nga Imer Selmani, por nuk arriti të mbijetojë politikisht. Pas daljes së Bardhyl Mahmutit nga PDSH-ja, lindi Bashkimi Demokratik Shqiptar (BDSH). Pas luftës së vitit 2001, në skenën politike të Maqedonisë doli edhe një parti e re, Bashkimi

Demokratik për Integrim (BDI) themeluar në qershor të vitit 2002, pas shpërbërjes së Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare (UÇK). Që nga themelimi, kryetar i partisë është Ali Ahmeti, nën drejtimin e të cilit BDI-ja i fitoi të gjitha zgjedhjet parlamentare nga viti 2002 deri më 2014. Me përjashtim të periudhës 2006-2008, kur ishte opozitë, BDI-ja ishte në të gjitha koalicionet qeverisëse të Republikës së Maqedonisë dhe atë me LSDM-në (2002-2006) dhe me VMRO-DPMN-në (2008-2015). BDI-ja i fitoi edhe zgjedhjet lokale, duke marrë qeverisjen e komunave më të mëdha shqiptare. Edhe nga BDI-ja u ndanë anëtarët e saj, duke krijuar parti më të vogla; ish-deputeti Hysni Shaqiri krijoi partinë Bashkimi Demokratik Kombëtar (BDK), Rufi Osmani krijoi partinë Rilindja Demokratike dhe Gëzim Ostreni që krijoi Partinë e Unitetit. Ndërkohë, më 2014 u themelua partia politike “Lëvizja për reforma” me kryetar Zijadin Selën (në zgjedhjet 11 dhjetorit 2016 fitoi 3 mandate), ndërsa më 2015 u formua lëvizja “Besë” me kryetar Bilall Kasamin (në zgjedhjet e fundit fitoi 5 mandate, si koalicion “Rilindja me Besë”). (Arsim Sinani)

PARTITË POLITIKE TË MINORITETEVE NË KOSOVË. Në Republikën e Kosovës, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) janë të regjistruara 25 parti politike të komuniteteve pakicë (joserbe), që tubojnë pjesëtarë të pakicave turke, boshnjake, malazeze, kroate, gorane, rome, të ashkalinjve dhe egjiptiane. Këto parti politike të regjistruara siguruan 9 vende në Kuvendin e Kosovës qoftë përmes votës së drejtpërdrejtë (të fituar në zgjedhjet e vitit 2014), qoftë si vende të garantuara. Partitë politike të minoriteteve që arritën të përfaqësohen në Parlamentin e Kosovës janë: Partia Demokratike Turke (KDTP), Partia e Re Demokratike Boshnjake (NDSB), Partia e Ashkalinjve për Integrim (PAI), Partia Demokratike e Ashkalinjve të Kosovës (PDAK), Koalicioni Boshnjak “Vakat”, Partia Liberale Egjiptiane (PLE), partia gorane Koalicioni për Gorën dhe Partia e Re Rome e Kosovës. (Osman Ismaili.)

PARTITË POLITIKE TË SHQIPTARËVE NË LUGINËN E PRESHEVËS. Partitë e para politike të shqiptarëve në Luginë të Preshevës u themeluan në vitin 1990, afërsisht në kohë të njëjtë me partitë e tjera politike të shqiptarëve

në ish-Jugosllavi. Dy partitë e para, Partia Demokratike Shqiptare (PDSH) dhe Partia për Veprim Demokratik (PVD) u themeluan më 2 gusht 1990, përkatësisht 19 gusht 1990. Që të dy këto parti kanë selitë e tyre në Preshevë. Për dallim prej PDSH-së, PVD-ja ka shtrirje në të tri komunat e banuara me shqiptarë në Luginë të Preshevës, pra në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë. Themelues i PDSH-së ishte Ali Ahmeti, ndërsa kryetar aktual është Ragmi Mustafa. Themelues i PVD-së dhe udhëheqës i saj është Riza Halimi. Për një periudhë të shkurtër, në vitet 1993/1994, në Preshevë funksionoi edhe Partia Parlamentare (PP). Parti të tjera, të themeluara më vonë, janë: Lëvizja e Progresit Demokratik (LPD), Bashkimi Demokratik i Luginës (BDL), Unioni Demokratik Shqiptar (UDSH) dhe Rilindja Demokratike (RD). LPD-ja u themelua në vitin 2002, si parti politike e dalë nga ish-strukturat politiko-ushtarake të UÇPMB-së, me kryetar Jonuz Musliun. Veprimtaria e LPD-së është e shtrirë vetëm në komunën e Bujanocit. BDL-ja u themelua, gjithashtu, në vitin 2002 me një numër anëtarësie nga PVD-ja. BDL-ja ka shtrirje vetëm në komunën e Preshevës dhe për kryetar ka Skënder Destanin. UDSH-ja u themelua në vitin 2005 nga Rami Zulfiu dhe bashkoi kryesisht ish-anëtarë dhe zyrtarë të lartë të partive të tjera politike. RD-ja u themelua në vitin 2011 nga disa aktivistë politikë dhe me nismë të Naser Nuredinit dhe Besim Abdulit. RD-ja ka mandatin e dytë në pjesëmarrje në pushtetin lokal të komunës së Preshevës, si pjesë e koalicionit parazgjedhor me PDSH-në. (Qerim Qerimi).

PARTITË POLITIKE TË SHQIPTARËVENË MAL TË ZI. Partia e parë politike e shqiptarëve në Mal të Zi është Lidhja Demokratike në Mal të Zi, e themeluar më 9 shtator 1990, me seli në Ulqin. Kryetar aktual dhe themelues i saj është Mehmet Bardhi. Më 21 nëntor 1993 u themelua Unioni Demokratik i Shqiptarëve (UDSH), me themelues dhe kryetar Ferhat Dinoshën. Forca e Re Demokratike ("Forca"), është një tjetër parti politike shqiptare, që u krijua në Ulqin më 22 tetor 2005, me kryetar Nazif Cungun. Për një kohë kjo parti e qeverisi Ulqinin. Në zgjedhjet e fundit parlamentare të vitit 2012 ajo hyri në aleancë me Lëvizjen "Perspektiva" dhe Iniciativën Qytetare "Tuzi" dhe siguroi një ulëse në Parlamentin 81-anëtarësh të Malit të

Zi. Në zgjedhjet parlamentare të 10 shtatorit 2006 në Mal të Zi mori pjesë edhe një parti e re politike shqiptare, Partia e Prosperitetit Demokratik (PPD). Në këto zgjedhje, PPD-ja, në koalicion me UDSH-në, siguroi një ulëse në Parlamentin e Malit të Zi. Një formacion tjetër politik shqiptar, Partia Demokratike, u themelua në Ulqin më 24 dhjetor 2011. Kryetar i kësaj partie është Fatmir Gjeka. Në zgjedhjet e fundit parlamentare të vitit 2012, Partia Demokratike garoi në koalicion me Alternativën Shqiptare, të udhëhequr nga Gjergj Camaj dhe Lidhjen Demokratike në Mal të Zi, duke siguruar një ulëse në Parlamentin e Malit të Zi. (Qerim Qerimi).

PARTNERITETI PUBLIKO-PRIVAT (PPP). Është një sipërmarrje e përbashkët e sektorit publik me sektorin privat për realizimin e projekteve kryesisht infrastrukturore apo për shërbime të ndryshme publike. Në PPP secila palë angazhohet në ato aktivitete që ka përparësi krahasuese dhe, si rrjedhojë, projektet apo shërbimet publike mund të kryhen në mënyrë më efikase dhe me kosto më të ulët. PPP-të janë të përhapura në sektorët e infrastrukturës, si: në transport, në shëndetësi, arsim, bujqësi apo në ofrimin e shërbimeve publike, siç është furnizimi me ujë, me rrymë, me ngrohje apo menaxhimi i mbeturinave. Në kushtet e pamjaftueshmërisë së fondeve publike për të plotësuar nevojat dhe pritjet për investime në infrastrukturë dhe në shërbimet e ndryshme publike, PPP-të janë shndërruar në aranzhmane shumë të përhapura, duke shfrytëzuar burimet financiare dhe efikasitetin e sektorit privat. Në Kosovë numri i aranzhmaneve të realizuara përmes PPP-ve mbetet i ulët. Megjithatë, është krijuar kuadri ligjor dhe institucional, i cili rregullon këtë fushë. Projekti më i madh i kësaj natyre, i kontraktuar nga Qeveria e Kosovës, është koncesioni i Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari". Projektet e tjera lidhen me infrastrukturën rrugore apo shërbimet po në këtë infrastrukturë. Në nivel lokal janë në fazë dizajnimi disa projekte që lidhen kryesisht me transportin publik. (Alban Hashani)

PASURIA KOMBËTARE. Është vlera e përgjithshme e pasurisë publike dhe private e një vendi në kohë të caktuar, e shprehur në para. Përfshin kapitalin, produktet dhe

shërbimet, bilancin neto të marrëdhënieve me botën dhe pasurinë e prekshme, asetet fizike. Përfshin edhe pasuritë (resurset) natyrore, infrastrukturën dhe teknologjinë (pronësinë industriale). Pasuria nacionale neto paraqet pasurinë e përgjithshme, minus obligimet ndaj kreditorëve. Është një tregues i vlefshëm për të matur aftësinë e një vendi për të hyrë në borxh në botën e jashtme dhe për ta kontrolluar ngarkesën me borxhe. Si tregues nuk përdoret edhe aq shumë në analizat ekonomike. Agjencia e Statistikave e Kosovës nuk publikon të dhënat mbi pasurinë kombëtare të Kosovës. (Muhamet Mustafa)

PASURITË MINERALE. Lëndë të para natyrore (minerale natyrore), nga të cilat mund të nxirren metale ose produkte të tjera që përdoren drejtpërdrejt në ekonomi. Që në kohërat më të vjetra treva e Kosovës ka qenë e njohur për pasuritë e saj të nëntokës. Pasuritë minerale të Republikës së Kosovës janë të shumëllojshme në sasi dhe cilësi dhe kanë rëndësi të madhe ekonomike. Ato ndahen në dy grupe: Në grupin e parë janë përfshirë pasuritë minerale, të cilat ndodhen në sasi të mëdha, si qymyri, mineralet e Pb-Zn, Ni-Co, Mg, Cr, Al, bentonitet dhe kaolini, që kanë rezerva të mëdha gjeologjike; ndërsa në grupin e dytë përfshihen pasuritë minerale jometalore, mjaft të përhapura, që mund të përdoren si material ndërtimi dhe në industri (argjilet, asbesti, leucitet, haloizitet, dunitet, bentonitet, kalcitet, tufet, talku, pegmatitet, granatet, rëra kuarcore, bigori, brekçet, gurët zburues, gurët gëlqerorë, zhavorri) si dhe ato metalore (mangani, hekuri, antimoni), të cilat gjeologjikisht nuk janë hulumtuar mjaft as nga ana e procedimit teknologjik.

Përveç këtyre mineraleve, në trevën e Kosovës janë regjistruar dhe shfaqje të tjera minerale, si nafta dhe gazi, zhiva (cinobarit), metalet e rralla, bakri, mineralizimet polimetalore të Fe, Ni, Co dhe Cr, Au dhe grupi i platinës dhe uraniumit. Për Kosovën pasuritë minerale kanë rëndësi të veçantë, pasi ato në prodhimin shoqëror të ekonomisë së vendit kanë marrë pjesë me rreth 48% dhe në punësim 39% (1988), kurse në eksport afër 70%, me gjithë faktin se këto kishin arritur shkallë të vogël të shfrytëzimit dhe të finalizimit të tyre kompleks. Nga aspekti i ndërtimit gjeologjik, treva e Kosovës nuk është studiuar sa duhet.

Hulumtimet e deritashme ishin të orientuar veçanërisht në pasuritë minerale metalore të Pb-Zn dhe qymyrit. Hulumtimet e fuqizuara të lëndëve minerale jometalore filluan më vonë (1975). Si pasojë e zhvillimit të proceseve gjeologjike dhe e ndryshimeve të ndodhura në trevën e Kosovës janë formuar vendburime të rëndësishme, në radhë të parë të xeherorëve polimetalore: Pb-Zn dhe të shoqëruesve të tyre (Ag, Au, Bi, Sb, Cd, Cu, Mn etj.) të nikelit, manganit, aluminit, kromit dhe të lëndëve të tjera jometalore të përmendura më lart. Rëndësi të veçantë ekonomike ka qymyri linjit, i krijuar në epokën gjeologjike të pliocenit, i cili është zbuluar në tri basene me rezerva të përmasave gjigante (14 miliardë tonë). (Minir Dushi)

PASURITË NATYRORE. Është tërësia e burimeve (resurseve) dhe e kushteve natyrore, të cilat njeriu i shfrytëzon për përmbushjen e nevojave të tij, që shërbejnë edhe për zhvillimin ekonomik të shoqërisë njerëzore. Pasuritë (resurset) natyrore janë të llojllojshme dhe të shumta: tokat, pyjet, ujërat, ajri, energjia diellore, energjia e erës, energjia e baticës dhe gjeotermale, fauna, lëndët e para minerale etj. Për nga prejardhja mund të jenë pasuri natyrore të atmosferës (erërat, shiu, dielli), të litosferës - kores së Tokës (tokat, mineralet e dobishme), hidrosferës (ujërat e steresë dhe deteve) dhe biosferës (fauna dhe flora). Pasuritë natyrore zakonisht ndahen në dy grupe: pasuri natyrore të ripërtërishme dhe të paripërtërishme. Në grupin e resurseve natyrore të ripërtërishme përfshihen pyjet, tokat, uji, era, batica, rrezatimi diellor, bimësia, rëra e zhavorri etj. Këto resurse pas shfrytëzimit ripërtërihen në mënyrë natyrore, në afate të ndryshme. Republika e Kosovës zotëron pasuri natyrore të shumëllojshme dhe të bollshme, gjë që mundëson një zhvillim të qëndrueshëm, edhe pse në dekadat e fundit këto pasuri janë shfrytëzuar në mënyrë të egër dhe të pakontrolluar, duke i dëmtuar rëndë ato. Nga pasuritë natyrore të ripërtërishme, Kosova zotëron toka bujqësore të shumëllojshme dhe pjellore, me sipërfaqe të përgjithshme prej 577,000 ha, edhe pse një pjesë e konsiderueshme e tyre është humbur për shkak të erozionit, braktisjes dhe të ndërimit të destinimit në tokë ndërtimore. Kosova disponon pasuri relativisht të mira ujore, me ujësi të territorit prej 10.5 l/s/km², pasuri ujore

sipërfaqësore prej 3,608 milionë m³ në vit, por me rreth 1,700 m³/banor/vit, megjithatë konsiderohet vend me mungesë potenciale të ujit. Edhe pse me një pasuri relativisht të kënaqshme ujore, për shkak të ndotjes, rritjes së kërkesës për ujë etj., sigurimi i ujit të pijshëm për popullsi, për industri, bujqësi etj., mbetet një problem i theksuar. Treguesit klimatikë, si resurs, janë: diellosja mesatare vjetore 2,100 orë dhe të reshurat mesatare vjetore nga 600 deri në 1400 mm.

Kosova është e pasur me pasuri natyrore të paripërtërishme (të shterrueshme), siç janë plumbi, zinku, kromi, linjiti, boksiti, nikeli, magneziti, bentonitet etj., disa nga të cilat karakterizohen me rezerva shumë të mëdha (plumbi, zinku, linjiti etj.). Për shkak të shfrytëzimit intensiv dhe për shkak të mungesës së investimit në kërkimet gjeologjike për zbulimin e rezervave të reja, kohëve të fundit vërehet një pakësim i rezervave të disa prej burimeve të paripërtërishme. (Vahdet Pruthi)

PASHIQ Nikolla (Nikola Pašić) (1845-1926). Politikan dhe burrështetas serb. Pasi kishte përfunduar Fakultetin e Inxhinierisë u angazhua në lëvizjen e Svetozar Markoviqit dhe deri në vitin 1878 ishte aktiv në luftën kundër regjimit të dinastisë së Obrenoviqëve. Në vitin 1878 zgjidhet deputet dhe në vazhdimësi ishte në krye të opozitës kundër qeverisë së Jovan Ristiçiqit. Më 1882 formoi Partinë Radikale Serbe dhe u zgjodh udhëheqës i saj. Pas Kryengritjes së Timokut (1883), për t'i shpëtuar burgut, emigron në Bullgari dhe atje qëndron deri më 1889. Me largimin e mbretit Milan nga Serbia, si udhëheqës i Partisë Radikale në vitin 1891-1892, Pashiçi zgjidhet kryeministër i qeverisë serbe. Nuk mori pjesë në organizimin e grushtit të shtetit kundër dinastisë së Obrenoviqëve më 1903, por nga kjo kohë dhe deri në vdekje ishte shumë aktiv në jetën politike të Serbisë. Ishte ministër i Jashtëm i Serbisë e më pas kryeministër. Gjatë Luftës së Parë Botërore ishte figura kryesore politike në shtetin serb. Në kohën e sundimit të tij u bënë dy luftëra ballkanike. Pashiçi ishte njëri nga iniciatorët dhe përkrahësi i realizimit të projektit të Serbisë së Madhe, në dëm të interesave të popullit shqiptar. (Isa Bicaj)

PASHKU Anton (1937-1995). Shkrimtar. Lindi në Grazhdanik, afër Prizrenit. Shkollën




ANTON PASHKU

fillore dhe pesë klasë të gjimnazit i kreu në Prizren, ndërsa tri klasët e fundit në Gjimnazin e Prishtinës. Gjithë kohën punoi në "Rilindje", një herë gazetar, pastaj redaktor i rubrikës së kulturës dhe në njëzet vjetët e fundit redaktor në Redaksinë e botimeve të "Rilindjes". Shkrimet letrare filloi t'i botojë që nga viti 1955. Shkroi prozë dhe drama. Është autor i temave shqiptare dhe i formave universale, që punën me formën e ktheu në kult, që veprën e mendon të identifikueshme me ekzistencën e kulturën nacionale moderne. Veprën e tij letrare e shkroi dhe e botoi në Prishtinë. Ai është autor i veprave: "Tregime" (1961), "Nji pjesë e lindjes" (tregime, 1965), "Kulla" (tregime, 1968), "Sinkopa" (dramë, 1969), "Oh" (roman, 1971), "Kjasina" (tregime, 1973), "Gof" (dramë, 1976), "Lutjet e mbrëmjes" (tregime, 1978), "Tragjedi moderne" (drama, 1982), që të gjitha të përfshira në kompletin trevëllimësh: "Tregime fantastike", "Oh" dhe "Tragjedi moderne" (1986). Vepra letrare e A. Pashkut është narrative (tregime e roman) dhe dramaturgjike. Por edhe te romani, ai e ruajti tregimin si amzë zhanrore të prozës, ndërsa dramën, së paku si diskurs, ruajnë veti të narrativës. Librat me tregime të Anton Pashkut janë: "Tregime", "Nji pjesë e lindjes", "Kulla", "Kjasina (tregime të zgjedhura)", "Lutjet e mbrëmjes" (tregime të zgjedhura). Tregimi është zhanri që mbizotëron në veprën letrare të A. Pashkut. Tregimet e tij e esencializojnë figurën, situatat e tyre janë të figurshme, personazhet bëhen figura etj. Tregimet e A. Pashkut tematikisht janë ekzistenciale dhe nacionale, gjithnjë të universalizuara. Kështu, kulla sështë figura lineare e traditës, por figura e hapur e esencës dhe e ekzistencës nacionale në vorbullën e ekzistencës (së ashpër) universale. Tregimet e A. Pashkut thuren në tri qarqe themelore tematike: të dashurisë, të vetmisë së kërkuar dhe të kushtëzuar nga një totalitarizëm dhe qarq tematik për dhunën mbi individin. Tregimet e tij më të njohura janë: "Nën qarr po rrinte vasha", "Floçka", "Kulla", "Si e përshkroi ëndrrën e vet njeriu me kapelë", "Dy fjalë për një plak dhe librin e tij kushtuar tymit", "Kënaqësitë e Megalopolisit", "Anija e dehur". Romani "Oh" është

vepra më e njohur e A. Pashkut dhe e anticipon gjithë veprën letrare të tij, prandaj kthehet në vepër përfaqësuese. Romani e lakon temën (e humbjes) në variantin universal, nacional (orale historik) dhe individual. Varianti oral i temës lidhet me ambientin shqiptar, qoftë kur artikullohet figura, qoftë kur hapet ideja. Ndërsa kur shkon te historia, A. Pashku gjen ndodhitë e rënda të Ilirisë dhe humbjen e lirisë. Ndërkaq, në rrafshin e poetikës, “Oh” e provon Pashkun stilist të madh të shqipes. Edhe pse i strukturuar me diskurs narrativ, teksti dramaturgjik i A. Pashkut njihet kategoritë themelore të gjinisë: dialogu/monologu, dramatikja/veprimi dhe didaskalitë. Kategoritë ekstrapurifikatore, nga udhëzueset janë bërë shenjues, për të prishur kufirin ndërmjet tekstit empirik (paratekstist) e tekstit-model dhe për ta shndërruar veprën në një sistem shenjues. Sistemi i tillë lidh fort për njëra-tjetrën kategoritë dramaturgjike dhe e esencializon formën e tekstit. Drama ka për esencë konfliktin dhe trajtë dialogun, ndërsa konflikti në dramën e A. Pashkut është i brendshëm, i lidhur me gjendje introspektive të figurshme. Teksti dramaturgjik i tij e esencializon gjuhën dhe e redukton veprimin. Loja e madhe zhvillohet në planin e formave, meqë Pashku do t'i barazojë funksionet e paratekstistit me intratekstin, funksionin e secilës shenjës. Këto veti i bëjnë dramën e tij vepra moderne. (Kujtim M. Shala)

PASHTRIKU. Mal në jugperëndim të Kosovës, përmes majës së të cilit kalon kufiri që e ndan Kosovën me Shqipërinë. U krijua gjatë orogjenezës alpine dhe paraqet një horst të ngritur deri



PAMJE E PASHTRIKUT

në lartësinë 1,988 m (maja e Pashtrikut). Ndërtohet kryesisht nga formacionet gëlqerore të kretakut, të cilët janë depozituar mbi formacionet e

ultrabazikëve. Në pjesët e Pashtrikut të ndërtuar nga gëlqerorët, parakusht për zhvillimin e kastit janë pastërtia, trashësia e konsiderueshme e tyre (nga 400-500 m deri 800-1000 m), copëtimi nga lëvizjet e reja tektonike dhe reshjet e bollshme. Janë krijuar forma interesante karstike: skriba, uvala, hinka, hurdha, shpella dhe përmendore të natyrës. Për shkak të shkëmbinjve karbonatikë, karakterizohet me rrjet të varfër hidrografik. Është relativisht i pasur me florë dhe faunë, madje disa lloje endemike edhe për livadhe e kulloza në pjesën e sipërme. Presioni sistematik i pasluftës mbi pyjet e Pashtrikut ka zvogëluar mjaft arealin e tyre. Pashtriku përfaqëson burimin kryesor të lëndës drusore dhe të ujit për komunitetin lokal. (Selim Qevani)

PATKOVO. Njësi administrative e fundit të shek. XII, që përfshinte vendbanime të rrethimave të Kukësit e të Gjakovës, përkatësisht pjesën më të madhe të hapësirës së quajtur Has. Shteti dhe Kisha e Rashës njihnin edhe një krahinë të vogël (zhupa) të quajtur Patkovo. Duket se kjo krahinë do të jetë quajtur në bazë të katundit me të njëjtin emër. Emri Patkovo përmendet edhe në krisobulat e Deçanit (1330,1335) dhe krisobulën e Shenjtorëve Mëhill e Gabriel të Prizrenit (1348?). Për herë të fundit përmendet në një shkrim latinisht të vitit 1618: “...dhe nga tokat greke Patkovën dhe gjithë Fosnon...” Duke qenë se ishte emër librar, ky emër nuk u ruajt për kohë të gjatë as nga popullata vendëse, as nga administrata e ardhësve serbë. Si nga popullata vendëse ashtu edhe nga administrata serbe u ruajt emërtimi i ri Has, i vendosur nga administrata osmane-turke. Dëshmia më e moçme që e dimë dhe që mund të lidhet me emrin e kësaj krahinëze është e vitit 1571. Në defterin turk të regjistrimit të atij viti është evidentuar se një banor i quajtur Gac Baci nga Helmshani i Kukësit kishte ardhur në katundin e quajtur Batka (më 1579), Patka të nahijes së Rudinës, përkatësisht të Hasit. (Skënder Gashi)

PATRIARKU SERB PAVLE (Gojko Stojčević) (1914-2009). Patriarku i 44-të i Kishës Ortodokse Serbe. U emërua patriark në vitin 1990 dhe udhëhoqi Kishën Ortodokse Serbe gjatë luftërave në ish-Jugosllavi. Lindi në fshatin Kuqanci te Donji Miholac, në Kroaci. Gjimnazin e kreu në Beograd, ndërsa i vazhdoi studimet për teologji në Sarajevë dhe Beograd.

Gjatë Luftës së Dytë Botërore jetoi në Tuzëll dhe Sarajevë, ku fillimisht punoi në ndërtimtari, e më pas, për shkak të shëndetit të lig, filloi jetën si murg në një manastir në Ovçar, në kufirin ndërmjet Bosnjës dhe Serbisë. Në periudhën 1949-1955 shërbeu në Manastirin "Raça" dhe në vitin 1954 mori titullin e murgut. Si peshkop i Rashkës dhe i Prizrenit u zgjodh më 1957. Ushtrroi ndikim në ndërtimin dhe rindërtimin e kishave serbe në territorin e Sanxhakut dhe të Kosovës. Pas vitit 1990, bashkë me Kishën Ortodokse Serbe, mbështeti politikën e Milloshëvqit dhe luftërat e Serbisë në Kroaci, Bosnjë dhe Kosovë. (Qemajl Morina)

PATRIKANA E PEJËS. Manastir i Kishës Ortodokse Serbe, i ngritur në afërsi të Pejës. Kompleksi i Manastirit të Patrikanës së Pejës është rindërtim i ndonjë objekti paleokristian



PATRIKANA E PEJËS

(shek. IV-VI), i cili u zbulua me rastin e konservimit të kompleksit në vitin 1938. Kompleksi i Patrikanës është rikonstruktiv i një objekti sakral, i cili ka funksionuar deri në adaptimin e tij, duke iu përshtatur liturgjisë bizantine dhe rasiene (shek. XIII). Edhe sot në anijatën e vjetër të Kishës së Shën Apostujve vërehen elemente të pjesshme të dyshemesë paleokristiane. Në freskat e saj janë të prezantuar edhe martirët e Ulpianës, Flori dhe Lauri, Konstandini i Madh, legalizues i krishterimit në Ediktin e Milanit (313), si dhe freska e Balshajve, zotërues të Pejës (vitet '70 të shek. XIV). Ngjitur me Kishën e Shën Apostujve është rindërtuar Kisha e Shën Dhimitrit, si dhe Kisha e Zonjës së Bekuar. Në anën jugore të kësaj kisha u ngrit Kishëza e Shën Nikollës.

Objektet e kompleksit u takojnë ndërtimeve të shkollës vendore, përkatësisht të kishave

të tipit kryq, i brendashkruar me kupolë. Pas rindërtimit të kompleksit të kishave të Patrikanës së Pejës është ndërtuar edhe hajati i përbashkët dhe pingu. Pingu sot nuk ekziston. Me këto objekte të adaptuara dhe të rindërtuara (shek. XIII-XIV) është krijuar kompleksi i Patrikanës. Dekorimet e kishave paraqesin një sintezë të stilit bizantin-roman-gotik, i gërshetuar me tipare autoktone. Kjo mënyrë e skulpturimit plastik ishte karakteristikë e shek. XIV për qendrat e Adriatikut, si Tivari, Kotorri, Ragusa, Ulqini, Shkodra, Apulia, Venediku etj. Enterierët e kishave në kompleksin e manastirit dhe të hajatit janë të pikturuara me freska të stilit monumental dhe narrativ. Pikturat, përveç që u takojnë stileve të ndryshme, ato gjithashtu janë realizuar në kohë të ndryshme: freskat e shek. XIII i takojnë stilit monumental të periudhës së dinastisë së Komnenëve bizantinë, ndërsa ato narrative i takojnë Renesansës së Paleologëve. Disa freska janë punuar nga piktorë që më parë kishin realizuar freska në Manastirin e Deçanit. Realizimi piktural mbështetet në modele monumentale të artit paleokristian, që kalon prej formës antike në atë mesjetare (figurat e apostujve të realizuara në unazën e kubesë). Freskat më të bukura të stilit narrativ janë ruajtur në anijatën e kishës së Shën Apostujve. Pas rënies së Pejës nën Perandorinë Osmane, sipas defterit të vitit 1485, pjesa më e madhe e murgjive të Patrikanës e kishte braktisur manastirin. Me përtëritjen e Patrikanës më 1557 është ripërtërirë ikonostasi dhe freskat. Disa freska janë punuar edhe pas tërmetit (1619-1620). Manastiri është dëmtuar gjatë luftërave austro-osmane (1689-1690), ndërsa pas disfatës së kryengritjes shqiptaro-serbe (1736-1639), një pjesë e pjesëtarëve të fisit Kelmend, të shoqëruar nga Arsenije IV braktisën Pejën dhe u ngulitën në Srem të Panonisë.

Ndërhyrjet në kompleksin e Patrikanës së Pejës në vitin 2008 (ndërrimi i tërësishëm i fasadës), kishin për qëllim që kompleksi i Patrikanës të marrë elemente identike me atë të kompleksit të Manastirit të Zhiçës, prej nga është bartur këtu qendra peshkopale e Kishës Serbe, pas sulmeve kumane dhe tatave (mesi i shek. XIII). (Jahja Drançolli)

PAVATAJ Haki (1941-1992). Veprimtar dhe dëshmor i arsimit. Lindi në Strellc të Epërm të Deçanit. Arsimin fillor e mori në vendlindje dhe në Isniq, ndërsa shkollën e mesme e filloi në

Gjakovë dhe e përfundoi në Prizren. Studimet i vijoi në SHLP të Prishtinës. Fillimisht ishte mësimsdhënës në shkollën fillore “Liria” në Isnig, pastaj drejtor i shkollës “Bajram Curri” në Strelc (1970-1992). U shqua si drejtor, veprimtar dhe atdhetar. Është bartës i shumë mirënjohjeve. Vdiq në krye të detyrës nga dhuna policore. (Demë Mulliqi)

PECI Tafil (1974-). Grafist. Lindi në Mitrovicë, shkollën fillore e kreu në vendlindje, Shkollën e Mesme të Artit në Pejë, ndërsa Fakultetin e Arteve, drejtimin e grafikës, në Prishtinë (2003). Punon kryesisht me shtypin e thellë, me teknikën e bakërshkrimit dhe të akuatintës me ngjyrë. Në grafikën e tij pasqyron tema sociale, duke e vënë figurën në plan të parë, të ndërlidhur me elemente asociative. Filloi të ekspozonte nga vitet 1996-1997 me ekspozitat personale në Galerinë “Liburna” në Mitrovicë, pastaj në vitin 2000 në Galerinë “Vizioni” në Prishtinë dhe më pas në Viene të Francës (2001) në “Salle des Fetes”, në Galerinë “Guri Madhi” në Korçë (2008) etj. Mori pjesë në një sërë ekspozitash të përbashkëta, si në Paris, Tokio, Luksemburg, Texas, Sofje, Madrid etj. Është fitues i disa çmimeve prestigjioze. Është kryetar i Shoqatës së Artistëve Figurativë të Mitrovicës. (Fatmir Krypa)

PECI Xhevdet (1955-). Boksier, trajner. Lindi në fshatin Zhazhë të Mitrovicës. Shkollimin fillor dhe të mesëm i kreu në Mitrovicë, ndërsa Fakultetin e Shkencave Sportive në Prishtinë. Nisi të merret me boks në moshën 16-vjeçare në KB “Akumulatori” të Mitrovicës. Në gjysmësezonin 1973/74 kaloi në KB “Prishtina”. Në periudhën 1975-1983 i fitoi pesë tituj të kampionit të ish-Jugosllavisë në boks. Është shpallur katër herë kampion i ish-Jugosllavisë për kategorinë e rëndë, ndërsa i ka fituar edhe dy tituj të kampionit ballkanik. Xhevdet Peci ka boksuar deri në vitin 1986, kur pas një padrejtësie në referim e pati goditur një gjyqtar serb, arsye që bëri të përjashtojë përjetë nga boks. Më vonë dënimi i është falur. Një kohë ka qenë përzgjedhës i përfaqësueses së Kosovës. (Bekim Aliu)

PEDERSEN Holger (1867-1953). Gjuhëtar danez, keltolog, albanolog dhe indoeuropianist. Studioi për gjuhësi në Universitetet e Kopenhagës, të Lajpcigut dhe të Berlinit. Studimet për sanskritishten i ndoqi në Uni-



HOLGER PEDERSEN

versitetin e Greisualdit. Studioi irlandishten dhe mbajti mësim për keltishten në Universitetin e Kopenhagës. Ishte ndër autoritetet e gjuhësisë së krahasuar të shek. XX, u mor konkretisht me gjuhët kelte, me armenishten, me tokarishten dhe me gjuhët sllave. Nga fundi i shek. XIX dhe në fillim të shek. XX u mor intensivisht me studimin e shqipes. Mblodhi tekste folklorike, përralla dhe këngë popullore shqiptare, me rëndësi për arelain e çamërishtes. Veprën e tij “Tekste shqiptare me fjalor” është me interes për gjuhësinë dhe për folkloristikën. Studimet e tij “Kontribut për historinë e gjuhës shqipe” (1894), “Tingujt / të shqipes” (1897), “Asnjësi i shqipes” (1899), “Grykoret në gjuhën shqipe” (1900), “Shqip 1905” kanë rëndësi për studimet e shqipes. Kishte kritikuar mbivlerësimin e ndikimit të latinishtes dhe të gjuhëve të tjera në shqipen. Mbronte tezën e prejardhjes së shqipes prej ilirishtes. Vuri në dukje se ndryshimi midis dy dialekteve të shqipes është më i vogël sesa ndryshimet dialektore që vihen re në shumë gjuhë të tjera. Është i njohur në gjuhësi për teorinë laringale. Ka lënë vepra me rëndësi për studimin e tokarishtes dhe të hetitishtes. Studimet e tij për gjuhën shqipe janë përkthyer dhe përmbledhur në vëllimin me titull “Studime për gjuhën shqipe”, botuar nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës në vitin 2012. (Mensur Vokri)

PEHLIVANËT. Lojë popullore e mundjes. Është e përhapur sidomos në Maqedoni dhe në një pjesë të Kosovës, por edhe të Sanxhakut. Paraqitja e pehlivanëve në Kosovë lidhet me



ardhjen e turqve. Garat e pehliuanëve zakonisht mbahen gjatë festave të verës, dasmave etj. Pehliuanët paraqiten të zhveshur deri në brez, mbajnë veshur poture të veçanta të lëkurës ("kismetë"), dhjetë centimetër nën gju. Para fillimit të luftës sportive lyhen me vaj, i cili forcon dhe mbron lëkurën dhe njëkohësisht vështirëson kapjen. Luftërat zhvillohen në hapësirën e kufizuar, në livadhe, dhe nisin me ritual të shoqëruar me tingujt e surleve dhe të tupanëve, si dhe me parakalimin e mundësve përreth arenës së garave. Lejohen të gjitha kapjet dhe hedhjet. Kohëzgjatja e luftës nuk është e kufizuar. Pehliuanët e humb ndeshjen, nëse arrijnë në pozitë të urës ose të gjysmurës, kur të dy shpatullat prekin tokën, nëse ngriten nga toka 25-35 cm dhe nëse kundërshtari dorëzon garën. Lufta mund të mbyllet edhe pa fitues (me barazim) me marrëveshje të mundësve. Kjo lojë popullore e mundjes ka dhënë shumë kampionë, si: Tefik Demiri, Shaban Sejdiu, Shaban Tërstena, Abdullah Mehmeti, Nijazi Sharapolli, Abaz Emini etj. (Vllaznim Bytyçi)

PEJA. Qytet dhe qendër e komunës me të njëjtin emër, që shtrihet në perëndim të Kosovës, rrëzë Bjeshkëve të Nemuna, në brigjet e Bistricës së Pejës, në lartësinë mbidetare 520



PEJA

m. Është qendër rajonale e Dukagjinit Verior nën administrimin e së cilës janë edhe komunat Istog, Klinë dhe Deçan, me një territor prej 1,831 km². Ka pozitë të volitshme gjeografike, ngase ndodhet në udhëkryqin e rrugëve që lidhin pjesën kontinentale të Gadishullit Ballkanik me bregdetin Adriatik përmes grykës së Rugovës, qafës së Çakorit dhe Rozhajës. Qyteti shtrihet në trekëndëshin aluvial të grykës së Rugovës, që zgjerohet në drejtim të fushës. Në truallin

e sotëm të qytetit, përkatësisht në lokacionin e Patrikanës dhe Fabrikës së Baterive janë gjetur gjurmë arkeologjike të epokës së neolitit dhe të periudhës ilire, që ndërlidhen me ekzistencën e qytetit të vjetër Siparunton të shek. III. Materialet e shumta nga parahistoria, antika, mesjeta, periudha osmane dhe ndërtimet e reja ruajnë një vazhdimësi, duke dëshmuar se këtu jeta nuk u ndërpre asnjëherë. Në shek. XII, Peja u pushtua nga Nemanjidët, kurse në shek. XIII ajo bëhet qendër e argjipeshkëvisë serbe. Pas rënies së kësaj dinastie në vitin 1371, Peja u administrua nga Balshajt dhe Dukagjinët. Në shek. XIV përmendet si qendër e rëndësishme tregtare dhe zejtare. Sipas defterit të sanxhakut të Shkodrës të vitit 1485, Peja ishte qendër e nahiës me 7 mëhallë dhe mbi 3,000 banorë, kurse në vitin 1592 kishte 18 mëhallë me 153 shtëpi. Sipas hartograftit V. M. Coroneli, pas rreth njëqind vjetësh (1689) ajo përmendet si qendër e rëndësishme me 600 shtëpi dhe me rreth 4,000 banorë. Gjatë sundimit osman qyteti mori fizionomi tjetër, me xhami të shumta, hamame, teqe, çarshi të mbyllur etj. Shtëpitë e grumbulluara në lagje rreth xhamive, me rrugë të ngushta e të spërdredhura, të shtruuara me kalldrëme, kopshte të rregulluara dhe të rrethuara me mure të larta, me shumë vija të ujit dhe jaze që kalojnë nëpër to, Pejës i japin karakterin e një qyteti oriental. Në pjesën qendrore të qytetit u zhvillua çarshia e mbyllur me shumë dyqane dhe zeje të ndryshme. Edhe sot janë të ruajtura disa shtëpi feudale, si Konaku i Tahir Begut, Kulla e Jashar Pashës, Kulla e Sheremetit, të gjitha të ndërtuara prej guri. Sipas A. Bues, Peja në vitin 1836 kishte 2,000 shtëpi me rreth 8,000 banorë, ndërsa pas 30 vjetësh (1866), sipas konsullit francez në Shkodër ajo kishte 20,000 banorë. Në këtë periudhë Peja ishte qendër e kazasë, kurse nga viti 1881-1912 ishte qendër e sanxhakut. Sipas Sami Frashërit, Peja në vitin 1896 kishte 18,000 banorë. Ajo njihet edhe si vatër e rezistencës kundër pushtimit osman, me Kuvendin e vitit 1899 dhe formimin e Lidhjes Shqiptare të Pejës. Në vitin 1912 Peja u pushtua nga serbët dhe me këtë filloi një periudhë e rëndë, e cila zgjati një kohë të gjatë. Nga dhuna, shumë familje u shpërngulën për në Turqi, kurse në vend të tyre u sollën kolonë sllavë. Në periudhën ndërmjet dy luftërave botërore Peja ishte një qytet kryesisht bujqësor e tregtar, pa ndonjë përparim të theksuar. Në këtë kohë u ndërtua

fabrika e tullave dhe e tjegullave, një mulli dhe dy sharra për përpunimin e drurit. Në vitin 1921 qyteti kishte 18,577 banorë, kurse në vitin 1961 kishte 28,351 banorë. Sipas regjistrimit të vitit 1981 Peja kishte 9, 900 ekonomi familjare me 54,500 banorë, ndërsa sipas vlerësimeve të vitit 1991 numri i banorëve kishte arritur rreth 70,000. Në periudhën e pas luftës së vitit 1999 numri i popullsisë u rrit me shpejtësi të madhe. Sot në qytetin e Pejës jetojnë rreth 100,000 banorë.

Pas Luftës së Dytë Botërore, Peja pati një zhvillim të hovshëm ekonomik-shoqëror. U zhvilluan disa degë të industrisë me numër të konsiderueshëm të punëtorëve, si: industria e këpucëve dhe e konfeksionit, industria e drurit, industria ushqimore e prodhimit të sheqerit dhe të birrës, industria metalike, e baterive, e biçikletave, kombinati agroindustrial, kapacitete këto ekonomike që paraqitnin bazë të zhvillimeve të tjera të rëndësishme, si ndërtimin e komplekseve banesore, objekteve arsimore, shëndetësor, administrative etj. E gjithë kjo u reflektua në zgjerimin dhe fizionominë e qytetit, nga gryka e Rugovës në drejtim të fushës së Pejës. Qendra me bulevarde dhe godina të reja e të larta i japin pamje bashkëkohore këtij qyteti. Në qendër të qytetit janë të vendosura të gjitha objektet administrative dhe me rëndësi shoqërore, në fushën e Pejës kapacitetet industriale, në afërsi të Patrikanës qendra spitalore dhe në Karagaç parku i gjelbëruar me liqenin si pjesë rekreative e qytetit. Në luftën e fundit të vitit 1999, Peja u dëmtua rëndë nga agresioni serb. U shkatërrua çarshia me shumë dyqane zejtare, shumë shtëpi, banesa e objekte fetare, ndërsa u vranë dhe u zhdukën një numër i konsiderueshëm i banorëve. Sot Peja është qendër e rëndësishme arsimore, tregtare, e biznesit, shëndetësore dhe turistike me peizazhin urban dhe me rrethinën e saj tërheqëse. Shumë institucione të vendosura në këtë qytet janë të karakterit rajonal. (Ibrahim Ramadani)


PEJA (komuna). Shtrihet në pjesën perëndimore të Kosovës, me qytetin në qendër me të njëjtin emër. Kufizohet me komunën e Istogut në veri, të Klinës në lindje, Gjakovës në juglindje, Deçanit në jug dhe me Republikën e Malit të Zi në perëndim. Sipërfaqja 603 km², popullsia rreth 150,000 banorë, me 80 vendbanime dhe 27 qendra lokale. Morfologjia e ndryshueshme e relievit me karakteristika

të veçanta të peizazhit e bën territorin e Pejës njërin nga hapësirat më atraktive në Kosovë. Lartësia mbidetare sillet prej 395 metra deri në 2,552 metra. Pjesa perëndimore karakterizohet me reliev të lartë malor, e njohur si Beshkët e Nemuna, me shumë kreshta të larta malore, si: Hajla, Zhlebi, Liqenati, Guri i Kuq etj., me mbi 2,000 m lartësi. Ndërtimin gjeologjik të këtyre maleve e përbëjnë formacionet e paleozoikut, të mbuluara me ato të mesozoikut. Sedimentet e kretakut dhe dolomitët e triasit mbulojnë pjesën më të madhe të sipërfaqes së këtyre maleve. Në disa sektorë, sidomos në luginat e lumenjve, mbizotrojnë formacionet e rreshpeve argjilore, ranore dhe konglomeratet e permit, ndërsa ana lindore e komunës është fushore, pjesë e Rrafshit të Dukagjinit, që karakterizohet me dendësi të madhe të popullsisë dhe aktivitete të shumta njerëzore. Në aspektin gjeologjik zona e fushës dominohet nga sedimentet fluviale dhe ato liqenore. Për shkak të relievit kompleks dhe mes divergjencave të mëdha, shfaqen dy tipe klimatike: klima e mesme kontinentale në lindje dhe klima alpine në perëndim. Temperatura mesatare vjetore është 11.3°C, e janarit është 0.5°C dhe e korrikut 21.6°C. Në Pejë dominojnë erërat maritime, sidomos në stinën e dimrit, në pranverë dhe në pjesën e parë të verës. Sasia e reshjeve këtu është më e madhe se gjithkund në Kosovë. Prej fushës, në drejtim të maleve, sasia e reshjeve shkon duke u rritur nga 902 mm në Pejë, deri në 1,146 mm në Kuqishtë. Edhe rrjeti hidrografik është mjaft i dendur dhe i pasur me ujë. Lumi kryesor është Bistrica e Pejës me gjatësi 62 km, që derdhet në Drinin e Bardhë. Buron në lartësi të madhe mbidetare, mbi 2,200 m, ndërsa për shkak të pjerrtësisë së madhe, ka formuar luginën e ngushtë e të thellë, e njohur si gryka e Rugovës në formë kanionike, me brigjet vertikale deri 1,000 m. Prej Pejës deri në grykëderdhje, lumi Bistrica rrjedh nëpër pjesën më të ulët të fushës së Pejës. Për shkak të rrjedhës së ngadalshme ka formuar disa meandra dhe luginën e gjerë deri në 5 km. Rrafshinat e gjera aluviale në pjesën e poshtme të saj shpeshherë përmythen gjatë periudhave me reshje intensive. Degët kryesore të Bistricës së Pejës janë: lumi Haxhaj, lumi i Allagës, Sheu i Keq, lumi Bogë, Gryka etj. Pjesën më të madhe të territorit (43%) e mbulojnë pyjet, pastaj arat (34%) dhe kullotat (17%).

Potenciale të rëndësishme zhvillimore të komunës janë tokat bujqësore, pyjet, ujërat dhe

kushtet e volitshme për zhvillimin e turizmit. Tani industria dhe ndërmarrjet komerciale marrin pjesë me 38%, bujqësia 15%, transporti, tregtia, hoteleria dhe turizmi 37% dhe veprimtaritë e tjera me rreth 10%. Fusha e Pejës ofron bazë të mirë për zhvillimin e bujqësisë, sidomos për prodhimin e drithërave, perimeve, pemëtarisë etj. Pyjet ofrojnë mundësi të mirë për zhvillimin e industrisë së drurit, kurse sipërfaqet e shumta të kullosave ofrojnë mundësi për zhvillimin e blegtorisë. Territori i komunë së Pejës ka potenciale atraktive turistike natyrore, të cilat me bukuritë e tyre gjithnjë e më shumë po tërheqin numër të konsiderueshëm të turistëve nga vendi, por edhe nga jashtë. Gryka e Rugovës, e sidomos Alpet Shqiptare, me vlera të shumta ekologjike, geomorfologjike, me florën dhe faunën e pasur dhe të shumëllojshme, me peizazhet e jashtëzakonshme përgjatë rrjedhjeve lumore dhe liqeneve natyrore paraqesin atraksion gjithnjë e më të madh dhe si të tilla janë të rralla në Europë. (Ibrahim Ramadani)

PEJA Fatmir (1948-2017). Arkeolog, numizmat, epigrafist. Lindi në Mitrovicë, arsimin fillor dhe të mesëm i kreu në Pejë dhe studimet për histori dhe gjeografi në Gjakovë (1970). Një



FATMIR PEJA

ku një kohë ishte shef i sektorit të arkeologjisë (1999-2013). Është numizmati i parë shqiptar në Kosovë. Është autor i monografisë “Kalaja e Harilaqit” (2012) dhe i studimit “Monedhat antike në Kosovë” (2008), bashkautor i “Hartës arkeologjike të Kosovës” I (2006), si dhe i një numër studimesh shkencore të botuara në organe dhe revista shkencore brenda dhe jashtë vendit. Mori pjesë në simpoziume dhe kongrese të shumta shkencore dhe drejtoi disa ekspedita në fushën e kërkimeve arkeologjike në Kosovë (1978-2013). (Arben Hajdari)

PEJA Ismet (1937-). Këngëtar popullor. Lindi në Gjakovë. Talenti i tij u shfaq që në moshë



ISMET PEJA

Radio-Prishtinë si solist i rregullt, por sërish u kthye në qytetin e lindjes, ku vazhdon kultivimin e këngës popullore qytetare. Ka punuar në shkollën fillore “Zef Lush Marku”. Më 1954 regjistroi këngët “Këndo o zogu i malit”, “Kah dera të erdha”, në kujdesin e R. Mulliqit dhe L. Antonit. Më 1966/67 në “Akordet e Kosovës” këndon “Zambaku i Prizrenit” të A. Kocit, ndërsa me “Martesën” e G. Zajmit fitoi çmimin e publikut në “Akordet e Kosovës”. Ka marrë dhe çmimin e dytë me “Do t’i marr një arshikishtë” të S. Bytyçit dhe çmimin e parë me “Yjet e lirisë” të M. Peja, në festivalin “Gjakova këndon”. Në Festivalin mbarëkombëtar në Shkodër i jepet “Çmimi i Nderit” bashkë me Esat Bicurrin (1991). Është njohës i rreth 1,000 këngëve popullore qytetare. Ka dhënë shumë koncerte dhe është ndër këngëtarët që i ka qëndruar besnik shoqërisë “Hajdar Dushi” të Gjakovës. (Krenar Doli)

PEJA Mulla Dervish (1765?-1855?). Poet i letërsisë shqipe alhamiado, myderriz dhe dijetar fetar. Lindi në Pejë, në gjysmën e dytë të shek. XVIII. Pas mbarimit të studimeve në Stamboll, tërë jetën e kaloi në Pejë, si myderriz në Medresenë e Vjetër dhe predikues në Xhaminë e Kuqe. La në dorëshkrim një vepër poetike të shkruar me alfabet arab, me titull “*Vasijetname*” (Libërtestament). Libri është përmbledhje vjershash, më i vjetri i këtij lloji, që është gjetur deri tash në Kosovë. Janë gjetur katër kopje të ndryshme të Vasijetnames, por jo edhe autografi. Janë gjetur edhe fragmente të Vasijetnames nëpër biblioteka të ndryshme në Kosovë, gjë që tregon se kjo vepër kishte komunikuar me lexuesit. Dervish Peja në vitin 1805 bëri kopjimin e një vepre nga fusha e logjikës në gjuhën arabe. Të dhënat jetëshkrimore për këtë autor, sikundër dhe për shumicën e autorëve tanë të vjetër që kanë shkruar me alfabetin arab, janë të pakta. Është

të re. Me të kryer shkollën e mesme në Gjakovë, u regjistrua në Fakultetin e Drejtësisë në Sarajevë dhe në Akademinë e Muzikës. Për arsye shëndetësore i ndërpreu studimet dhe u kthye në vendlindje.

Më 1959 u punësua në

poeti i dytë pejan i alhamiados, pasues i Mulla Beqirit në letërsi. (Nehat Krasniqi)

PEJA Sami (1924-1999). Ekonomist, profesor universiteti. Lindi në Pejë, shkollimin fillor e mbaroi në Krumë të Hasit, të mesmen në Normalen e Elbasanit, shkollën e lartë në Pejë,



SAMI PEJA

Fakultetin Ekonomik në Prishtinë dhe magistraturën në Beograd. Mori pjesë në LNÇ si 16-vjeçar. Pas përfundimit të luftës emërohet sekretar komune në Pejë, por burgoset për arsye politike (1950-

1956). Pas burgut mbaron studimet dhe punon në ndërmarrjen “Tregtia e Kosovës”, pastaj në Odën Ekonomike të Kosovës dhe në Fakultetin Ekonomik, në fillim asistent në lëndën teoria e çmimeve, me mësim në gjuhën serbokroate, ndërsa me fillimin e studimeve në gjuhën shqipe, bëhet profesor i kësaj lënde, të cilën e ligjëroi deri në pension. Për nevojat e studentëve, S. Peja përktheu tekstin universitar “Teoria e çmimeve”, i cili atëbotë përdorej në ish-Jugosllavi, që u bë libri i parë i shqipëruar dhe u përdor nga shumë gjenerata studentësh. Përveç punës si pedagog, ai u veçua edhe për përkushtimin për lirinë dhe pavarësinë e vendit. Që nga viti 1990 mori pjesë në shumë aktivitetet politike dhe shoqërore të asaj kohe, përfshirë edhe aksionin për pajtimin e gjaqeve në Kosovë. (Ramiz Livoreka)

PEJANI Bedri (1885-1946). Veprimtar i çështjes kombëtare, politikan, arsimdashës, kryetar i Lidhjes së Dytë të Prizrenit. Lindi në Pejë. U shkollua në vendlindje dhe në Stamboll, ku kreu



BEDRI PEJANI

studimet për histori. Pas mbarimit të shkollimit merret me publicistikë. Në kohën e rinisë angazhohej për një federatë ballkanike. Më vonë u bë mbështetës i ideve të rilindësve shqiptarë, për një Shqipëri të pavarur, e cila duhej të shpallej sa

më parë me rrugë revolucionare, me Shkupin kryeqytet të saj. Angazhohet për hapjen e shkollave shqipe në të gjitha vilajetet shqiptare. Ishte pjesëmarrës në Kongresin e Dytë të Manastirit

(23 mars 1910) për unifikimin e alfabetit kombëtar, si dhe i bisedimeve të Shkupit (14 tetor 1912) për organizimin e mbrojtjes së trevave shqiptare nga Aleanca Ballkanike dhe pjesëmarrjes në Shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë më 28 nëntor 1912 në Vlorë. Kishte miq shumë patriotë shqiptarë, por më për zemër e kishte Isa Boletinin, të cilin e quante gjeneral. Pas themeimit të qeverisë së Ismail Qemalit ai merret me çështje të arsimit dhe të rinisë shqiptare. Një kohë ishte drejtor shkollë në Durrës, gjatë viteve 1914-1918 shërben në Kosovë për hapjen e shkollave shqipe. Më 1 maj 1918 në Shkodër u zgjodh sekretar i Komiteti të Kosovës. Në atë detyrë do të mbetet deri më 1943. Ishte pjesëmarrës në Kongresin e Lushnjës (1920) dhe përkrah Fan Nolit, Hasan Prishtinës dhe Ibrahim Gjakovës kur themelohet Komiteti Nacional Revolucionar (KONARE) në Vjenë (1925). E përkrahu edhe “Komitetin për Çlirimin e Kosovës”, i themeluar po në Vjenë në mars të vitit 1925, që kryesohej nga Hasan Prishtina. Si opozitar i regjimit të Zogut do të shkruajë në “La Federation Balquanique”, por edhe në “Liria kombëtare” gjatë viteve 1925-1935. Botoi rreth 500 artikuj e studime nëpër gazeta dhe revista të ndryshme. Është përpilues i disa peticioneve drejtuar Shoqatës së Kombeve në Gjenevë (1923-1931). Pas Kryengritjes së Fierit (1935) arrestohet, ndërsa pas lirimit më 1937, vendoset në Francë dhe me t’u kthyer nga Franca bashkëpunon me Koço Tashkon për të ngritur popullin në kryengritje antifashiste në Krahinën e Dibrës. Pas kapitullimit të Jugosllavisë më 1941 kthehet në Kosovë për të organizuar rrjetin arsimor dhe të administratës në gjuhën shqipe. Merr pjesë në Kongresin themelues të Lidhjes së Dytë të Prizrenit, por nuk e pranoi asnjë funksion për shkak të pranisë së një oficeri gjerman në sallë. Nga 17 janari e deri më 25 korrik 1944 ishte kryetar i Lidhjes së Dytë të Prizrenit. Pas hyrjes së forcave partizane në Kosovë në nëntor 1944, vendoset në Shkodër. Aty qëndroi i lirë derisa pushteti i Shqipërisë e dorëzoi te jugosllavët më 1945. Deri në shkurt 1946 do të qëndrojë në burg të Prizrenit dhe në një proces gjyqësor dënohet me vdekje. Helmohej nga agjentet e OZN-ës në spital, ku më pas vdes. (Hakif Bajrami)

PEJANI Sadi (1893-1964). Arsimtar reformator, njëri nga pararendësit e pedagogjisë dhe të shkollës moderne në Shqipëri. Lindi

në Pejë, ku mbaroi arsimin fillor në gjuhën turke, ndërsa shkollimin e mesëm e kreu në Shkup dhe Selanik. Filloi studimet e larta për drejtësi, por më pas kaloi në Institutin Pedagogjik dyvjeçar të Klagenfurtit (Austri), ku diplomoi për mësues në vitin 1918. Ishte drejtor i shkollës fillore në Durrës, kryemësues i shkollës shqiptaro-amerikane në Tiranë, drejtues i disa shkollave-konvikte në Tiranë, Ersekë, Sarandë. Gjatë vitit shkollor 1941/42 ishte mësimdhënës në Institutin Tregtar dhe Normalen e Gjakovës. Ishte nismëtar dhe organizator i krijimit të sindikatës së mësuesve, përkatësisht kryetar i Lidhjes së Mësuesve në Shqipërinë e Mesme, pjesëmarrës aktiv në Kongresin Arsimit të Tiranës dhe pjesëmarrës në Kongresin I të Arsimitarëve Antifashistë në Korçë. S. Pejani ishte njëri nga themeluesit dhe drejtues i revistës pedagogjike “Edukata e re” në Tiranë. Përktheu, përshtati ose shkroi dhe botoi disa vepra dhe broshura nga letërsia, historia, gjeografia etj., të gjitha në shërbim të shkollës dhe të nxënësve. Botoi shkrime në gazetën “Kosova” të Tiranës. (Hajrullah Koliqi)

PEJÇINOVIQ (Pejčinović) Dragoslav (1932-). Biolog, profesor universiteti, akademik. Lindi në Vladiçin Han. Një kohë punoi mësimdhënës i biologjisë në gjimnazin e Gjilanit, më pastaj zgjidhet asistent i biologjisë në Fakultetin Filozofik (1955) të Universitetit të Prishtinës. Tezën e disertacionit të doktoratës e mbrojti nga fusha e biologjisë në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore të Universitetit të Beogradit. Ishte dekan i Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore dhe prorektor i Universitetit të Prishtinës. Në vitin 1986 zgjidhet anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe anëtar i rregullt më 1991. Botoi punime shkencore e profesionale nga fusha e shkencave biologjike dhe mori pjesë aktive në tubime shkencore brenda dhe jashtë vendit. Është marrë me studimin e bimëve mjekësore. (Fetah Halili)

PEKMEZI Gjergj (1872-1938). Gjuhëtar, diplomat, profesor dhe folklorist shqiptar. Lindi në Tushemisht të Pogradecit. Shkollimin fillor dhe të mesëm i përfundoi në Ohër dhe Manastir, ndërsa studimet universitare i ndoqi në Beograd dhe Vjenë. Në vitin 1903 u emërua përgjegjës për mësimin e shqipes në Universitetin Oriental të Vjenës. Më 1904 themeloi



GJERGJ PEKMEZI

profesor në Universitetin e Vjenës për gjuhë shqipe. Vepra shkencore e Pekmezit lidhet me gramatikën, dialektologjinë dhe folklorin. Me porosi të Akademisë së Shkencave të Austro-Hungarisë hartoi monografinë në dorëshkrim “Tiparet dalluese thelbësore të dialekteve kryesore të shqipes, të toskërishtes dhe gegërishtes”, një ndër studimet e para të dialektologjisë shqiptare. Pastaj botoi punimin “Raport provizor për studimin e së folmes së Elbasanit” (1901). Bashkëpunoi me gjuhëtarët R. Nahtigal, N. Jokl etj. Më 1908 botoi në Vjenë “Gramatikë e gjuhës shqipe” gjermanisht, një ndër veprat më të mira të gjuhësisë shqiptare për atë kohë. Më 1909 u botua “Bibliografia shqiptare”, ku Pekmezi ishte bashkautor. Në bashkëpunim me gjuhëtarë gjermanë botoi “Udhëzuesi i gjuhës shqipe”, “Libër mësimi e ushtrimesh në gjuhën shqipe” (1913), “Gjuha shqipe dhe dialektet”. Transkriptoi librin “Bleta Shqiptare” të Thimi Mitkos. Mblodhi mijëra faqe me materiale e relacione të konsujve austro-hungarezë të Shkodrës, Prizrenit, Janinës, Stambollit nga arkivi i Ministrisë së Jashtme të Austro-Hungarisë. (Ardita Berisha)

PELEGRINI Xhovan Batista (Giovanni Battista Pellegrini) (1921-2007). Studiues italian, gjuhëtar, albanolog. Lindi në Belluno. U diplomua për gjuhësi në Universitetin e Padovës (1945). Figurë e njohur e gjuhësisë italiane dhe ballkanike. Profesor i Universitetit të Padovës, mbajti mësim dhe për gjuhë e letërsi shqipe. Studimet e tij shtrihen nga toponomastika tek onomastika italiane e arabe;



XHOVAN PELEGRINI

nga zbërthimi i mbishkrimeve venete në studimin e dialekteve të sotme të krahnës së Venetos; nga kërkimet në gjuhësinë

romane, gjermane e sllave në hulumtimet e gjuhëve të Italisë së lashtë, në studimet mbi shqipen, hungarishten etj. Ka shfaqur interesim për çështjet e fonetikës, të gjuhësisë historike dhe të leksikologjisë. Midis botimeve të tij me interes për shqipen janë: “Hyrje në studimin e gjuhës shqipe” (Introduzione allo studio della lingua albanese”, Padovë 1977); “Kërkime gjuhësore ballkanike-danubiane” (Ricerche linguistiche balcanico-danubiane”, Romë 1992) dhe “Hyrje në gjuhësinë shqiptare” (Avviamento alla linguistica albanese”, Palermo 1995). (Shpëtim Elezi)

PELINI Gjergj (Novobërdasi) (?-1463). Latinisht: *Georgius Pelino, Georg/Georgo Pelinus/Pellinus* etj. Ambasador dhe diplomat i Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, njëri ndër personalitetet më të shquar të Tivarit në shek. XV. Lindi në Novobërdë dhe një pjesë të jetës e kaloi duke drejtuar kuvendin benediktin të Shën Mërisë në Rotec, afër Tivarit (1436-1463). Sipas lëndës arkivore, aktiviteti diplomatik i abatit Pelini mund të ndiqet së paku nga viti 1438. Më 1448, Pelini mori pjesë me Ndreun (ipeshkëv i Arbërisë) në Traktatin e paqes në mes të Skënderbeut dhe Venedikut, që përfaqësohej nga Paolo Loredan e Andrea Venier. Traktati i paqes, që u nënshkrua në kampin e Skënderbeut, caktonte që Danja t'i mbetej Venedikut, por edhe Skënderbeu të merrte shpërblimin përkatës financiar. Dy vjet më vonë, në emër të Skënderbeut, Pelini i ofronte Venedikut sovranitetin mbi Krudjën. Në vitin 1456, ai kishte ndërmjetësuar në zgjidhjen e një sërë çështjesh të diskutueshme mes Venedikut dhe Skënderbeut. Në vitin tjetër (qershor 1457), përveç ankesave të Skënderbeut ndaj Venedikut rreth mospagimit të taksave dhe shkeljen e privilegjeve të dakorduara më parë, Pelini, kishte kërkuar nga Republika që t'i lejohet Skënderbeut të dilte në Zetë, e cila në atë kohë pjesërisht ishte nën osmanët. Gjatë shtrëngesave të paraqitura, Pelini kishte përfituar nga rasti që t'i kërkonte Senatit të Venedikut katër fshatra, të cilat i kishte pushtuar më parë konti Vojinoviç. Po në këtë vit Pelini u angazhua edhe te Papa Kaliksti III, që Skënderbeut t'i vazhdoheshin ndihmat financiare. Para vdekjes, i papëlqyer në Tivar, Pelini kishte kërkuar të shkonte në Venedik dhe atje ta kalonte pjesën tjetër të jetës. Në cilësi të diplomatit për herë të fundit e ndeshim në Venedik në vitin 1463. (Jahja Drançolli)

PELLAZGËT. Popullsia e lashtë mesdhetare parailire dhe paragreke. Fillimet e historisë së pellazgëve në Gadishullin Ballkanik janë mjaft të errëta dhe njohuritë për ta vijnë nga autorët antikë, të dhënat e të cilëve shpeshherë janë kontradiktore, sidomos rreth shtrirjes së tyre. Homeri i përmend pellazgët si banorë të Thesalisë dhe të Kretës dhe i quan “hyjnorë”, fis i lindur nga hyjnitë (“Iliada”). Autorët e tjerë, si Skymni, Hesiodi, Herodoti, Hekateu, Tukididi japin njoftime të tjera, duke i vendosur pellazgët herë në Peloponez, herë në Azi të Vogël e herë në Itali. Sipas gjeografit Skymni, pellazgët banonin edhe në trevën e molosëve dhe shkruan se tek ata ndodhet edhe Dodona, faltore e Zeusit, e themeluar prej pellazgëve. Herodoti njofton se pellazgët besonin në shumë perëndi dhe ripohon para gjeografit Scymnit “se në Dodonë ndodhet orakulli i tyre dhe se e kishin zakon që për çdo gjë t’u bënin fli perëndive, ndërsa orakulli i Dodonës ishte më i lashti i Heladës”. Pellazgët, sipas Scymnit dhe Strabonit, flisnin një gjuhë barbare, jogreke. Përcaktimi etnik i pellazgëve u shtrua si problem qysh herët (Straboni, Skymni), ndërsa Herodoti i përmend pellazgët në shek. V p.e.r. si enklava në territorin e Greqisë antike. Me problemin pellazg u morën shumë shkencëtarë gjatë shek. XIX-XX, të cilët dhanë mendime të ndryshme rreth origjinës, gjuhës dhe kulturës së tyre. Tezat e hipotezat për identitetin e pellazgëve dhe për raportet e tyre me popullsitë e tjera shkojnë nga mohimi i ekzistencës së tyre, deri te përpjekjet për t’iu veshur tipare të veçanta e të përcaktuara në pikëpamje etnike e gjuhësore. Pas dyndjeve indoeuropiane nga mijëvjeçari III p.e.r. u bë një ndërthurje e banorëve autoktonë me elementët e rinj të ardhur indoeuropianë, mbi bazat e së cilës u krijuan më pas popujt e njohur edhe historikisht. Sot, për emërtimin e popullsisë së tejlashtë ballkanike shumë studiues parapëlqejnë të përdorin termat: parailirë, paratrakë, paragrekë. Sipas studiuesve shqiptarë e të huaj, pellazgët ishin paraardhësit e ilirëve. (Sedat Barajliu)

PELLAZGJISHJA. Gjuhë e pellazgëve, popullatë e lashtë që mendohet të ketë jetuar në vise të Greqisë së sotme. Fillimisht ishte menduar të ketë qenë e afërt me gjuhët e Kaukazit, me baskishten dhe me etruskishten. Të tjerë në shek. XIX me këtë emërtim kuptonin gjuhët

indoeuropiane, si greqishtja, italikishtja, por edhe shqipja. Kjo ide ishte përhapur edhe tek autorët arbëreshë e shqiptarë (N. Keta, J. De Rada, S. Frashëri). Sot ka dy hipoteza kryesore për pellazgjishten. Njëra e sheh gjuhë paraindoeuropiane, tjetra e koncepton si gjuhë indoeuropiane, që mund të ketë lidhje me anatólishten, të ketë qenë fazë para-trakase apo e ndonjë gjuhe tjetër, të ketë pasur lidhje me parashqipen, degë e indoeuropianishtes. (Drita Tërshani)

PELLGJET (UJËMBLEDHËSIT) LUMORE.

Hapësirë gjeografike në të cilën ujërat e reshjeve rrjedhin në drejtim të një lumi, liqeni, deti apo oqeani. Për shkak të pozitës gjeografike, ndërtimit gjeologjiko-tektonik dhe veçorive morfologjike, ujërat e Kosovës rrjedhin në drejtim të tri deteve: Detit të Zi, Adriatik dhe Egje. Tipar i veçantë fiziko-gjeografik që dallon Kosovën nga vendet e tjera të Gadishullit Ballkanik është pozita hidrogeografike në "kulmin" e rrjedhave ujore. Ndarja e ujërave rrjedhëse në drejtim të tri deteve bëhet nga nija hidrografike e Gadishullit Ballkanik, Suka e Dërmanit (1,364m), e cila ndodhet në mes të Maleve të Jezercit dhe Nerodimes (12 km në lindje të Suharekës).

Si karakteristikë hidrogeografike e Kosovës është dukuria e përputhjes së lartë të sipërfaqes shtetërore (10,887 km²) me sipërfaqen topografike të ujëmbledhësve detarë (11,645 km²). Nga kjo rezulton se sipërfaqja ujëmbledhëse (Deti i Zi, Adriatik, Egje) është vetëm 6.5% më e madhe se ajo shtetërore. Ky fakt tregon se rrjeti hidrografik i Kosovës është autokton (domicil) në pjesën më të madhe të ujërave dhe se ujërat e Kosovës janë ujëra transite, që rrjedhin në drejtim të deteve përreth. Rrjeti hidrografik i Kosovës përbëhet nga katër sisteme lumore: Drini i Bardhë (deti Adriatik), Ibrë me Sitnicën dhe Morava e Binçës (Deti i Zi) dhe Lepenci (deti Egje).

Në aspektin sipërfaqësor, pjesa më e madhe e territorit të Kosovës, 5,602 km² ose 51.4% kullon ujërat në drejtim të Detit të Zi.

Ibrë është arteria kryesore lumore. Ai dallohet jo vetëm për sipërfaqen më të madhe, por edhe nga prurja mesatare vjetore. Buron nga gurat karstike në afërsi të Rozhajës, në Mal të Zi, rrjedh në drejtim të lindjes përmes Serbisë dhe futet në territorin e Kosovës. Në Kosovë, në lumin Ibër është ndërtuar akumulimi më i madh

në vend, liqeni i Ujmanit (Gazivodës). Sitnica është dega kryesore e Ibrë, e cila rrjedh përgjatë Fushës së Kosovës në drejtimin meridional (jug-veri). Degët kryesore të Sitnicës janë Llapi dhe Drenica. Në Mitrovicë Sitnica derdhet në lumin Ibër. Prurja mesatare vjetore e Ibrë në Leposaviq është rreth 30.8 m³/sek. Në pjesën juglindore të Kosovës rrjedh Morava e Binçës, e cila po ashtu kullon ujërat në drejtim të Detit të Zi. Morava e Binçës rrjedh kryesisht përgjatë Anamoravës. Dega kryesore e Moravës së Binçës është Krivareka. Me të dalë në Luginë të Preshevës, Morava e Binçës në grykën e Konçulit ka prurje prej 9 m³/sek. Në përgjithësi, prej territorit të Kosovës, në drejtim të Detit të Zi, brenda një sekonde dalin rreth 40 m³ ujë.

Në drejtim të detit Adriatik kullohet ujë me sipërfaqe prej 4,605 km² ose 42.3%, që përputhet me pjesën perëndimore të Kosovës. Drini i Bardhë është arteria kryesore hidrografike. Buron në gurrën e Radavcit, rrëzë majës së Rusolisë, rrjedh përgjatë fushës së Dukagjinit, derisa në Vërmicë kalon në territorin e Shqipërisë. Rrafshi i Dukagjinit pothuajse në tërësi i takon pellgut të detit Adriatik. Drini i Bardhë paraqet ujëmbledhësin më të madh, lumin më të gjatë dhe më të pasur me ujë në Kosovë. Nga Bjeshkët e Nemuna rrjedhin në drejtim të Drinit të Bardhë lumenjtë: Bistrica e Pejës, Bistrica e Deçanit, Bistrica e Lloqanit dhe Ereniku; nga mali Mokra rrjedh lumi i Istogut dhe i Klinës; nga malet e Carralëvës dhe të Drenicës rrjedh lumi Mirusha, nga malet e Jezercit rrjedh Toplluha; kurse nga Malet e Sharrit rrjedh Lumëbardhi i Prizrenit dhe lumi i Plavës. Mesatarisht, brenda një sekonde, në drejtim të detit Adriatik rrjedhin rreth 62 m³ ujë.

Në drejtim të detit Egje kullohen 679 km² ose 6.2% e territorit të Kosovës. Lepenci është lumi kryesor i këtij pellgu. Formohet nga rrjedhjet ujore nga pjesa veriore e Maleve të Sharrit. Në Kaçanik i bashkohet dega kryesore e Lepencit, Nerodimja. Mesatarisht brenda një sekonde nga territori i Kosovës në drejtim të detit Egje rrjedhin 9.1 m³ ujë.

Në bazë të karakterit transit që kanë ujërat e Kosovës, del se brenda një sekonde mesatarisht nga Kosova rrjedhin në drejtim të tri deteve rreth 110.9 m³ ujë. (Valbon Bytyçi)

PEMËTARIA. Në kuadër të bujqësisë është një degë shumë e rëndësishme për zhvillimin e gjithanshëm. Kosova ka kushte shumë të mira



NJË PLANTACION PEMËSH NË KOSOVË

agroklimatike për kultivimin e suksesshëm të shumë llojeve të pemëve kontinentale. Në Kosovë sipërfaqja e tërësishme me pemë sillet rreth 10,617 ha. Sipërfaqet më të mëdha me pemë gjenden në rajonin e Gjakovës, Ferizajt, Klinës, Gjilanit, Prizrenit, Istogut, Podujevës, Skënderajt etj. Ruajtja dhe përpunimi i pemëve bëhet në frigoriferë në Gjakovë, Ferizaj dhe Prizren. Frigoriferët me ngrirje të thellë të frutave në -18°C gjenden në Gjilan dhe Podujevë. Pemët kryesore kontinentale që mbillen në Kosovë janë: pemët farore, si molla (*Malus domestica* Borkh), dardha (*Pyrus communis* L.), ftoi (*Cydonia oblonga* Mill.), mushmolla (*Mespilus germanica* L.), vadhëzavojsa (*Sorbus domestica* L.); pemët bërthamore, siç janë kumbulla (*Prunus domestica* L.), kajsia (*Prunus armeniaca* L.), pjeshka (*Prunus persica* L.), qershia (*Cerasus-Prunus avium* L.), vishnja (*Prunus cerasus* L.), thana (*Cornus mas* L.); pemët thelbore, si arra (*Juglans regia* L.), lajthia (*Corylus avellana* L.), gështenja (*Castanea sativa* Mill.), bajamja (*Amygdalus communis* L., *Prunus dulcis* Mill.); pemët e imëta manore, ku bëjnë pjesë: dredhëza-luleshtrydhja (*Fragaria vesca* L.), mjedra (*Rubus idaeus* L.), manaferra (*Rubus fruticosus* L.), rrush serezi i zi (*Ribes nigrum* L.), rrush serezi i kuq (*Ribes rubrum* L.), rrush frëngu (*Ribes* sp.), boronica (*Vaccinium myrtillus* L.), boronica amerikane (*Vaccinium corymbosum* L.), boronica e kuqe (*Vaccinium vitis idaea*), boronica kokërrmadhe (*Vaccinium macrocarpon*, *myrtillus*), kivi-Aktinidija (*Actinidia chinensis* Planchon.), mani-dudmani (*Morus alba* L., *M. nigra* L.). (Agim Zajmi)

PEN QENDRA E KOSOVËS. Asociacion i shkrimtarëve të Kosovës, i themeluar nga një grup shkrimtarësh më 29 janar 2004 në Prishti-

në. Më 9 shtator 2004, në Kongresin e 70-të në Tromso të Norvegjisë, PEN Qendra e Kosovës (Kosova PEN Center) u pranua zyrtarisht në gjirin e organizatës më të madhe botërore të shkrimtarëve, në Internacional PEN (PEN-i Ndërkombëtar) me seli në Londër. PEN Qendrat e të gjitha shteteve të botës luajnë një rol të rëndësishëm në krijimin e një klime bashkëpunimi dhe të paqes në botë. PEN Internacional është një organizëm me rëndësi të veçantë për kulturën botërore dhe për marrëdhëniet midis komuniteteve. Nisur nga këto parime, PEN Qendra e Kosovës ka zhvilluar aktivitetin e saj në krijimin e kontakteve kulturore dhe në prezantimin e të arriturave letrare dhe artistike të Kosovës në botë. Fushëveprimtaria e saj shtrihet edhe në botimin e veprave të ndryshme letrare, shkencore, publicistike, eseistike, si dhe në organizimin e konferencave dhe debateve me karakter kulturor, por edhe në pjesëmarrjen e anëtarëve të saj në aktivitete të rëndësishme jashtë vendit. Kryetar i parë i PEN Qendrës së Kosovës është poeti Basri Çapriqi. (Sali Bashota)

PEONËT. Grup i fiseve të rëndësishme ilire, të cilët jetuan në pjesën qendrore të Ballkanit. Përmenden për herë të parë nga Homeri si aleatë të trojanëve në Luftën e Trojës, i cili i vendos në rrjedhën e lumit Axios (Vardar). Në lindje shtriheshin deri te lugina e Strymonit (Struma), ku kufizoheshin me trakët, ndërsa në perëndim me dardanët, penestët dhe dasaretët. Në vitin 490 p.e.r. u pushtuan nga persët, ndërsa në gjysmën e parë të shek. IV p.e.r. krijuan mbretërinë e tyre dhe u njohën për rezistencën kundër pushtimit maqedonas. Megjithëkëtë, një pjesë e territorit u pushtua nga Filipi II i Maqedonisë (358 p.e.r.) dhe peonët njohën sovranitetin e Maqedonisë. Pas vitit 284 p.e.r., pasi Aristoni, djalë i mbretit peon Audoleonit, kaloi lumin Astibo me not dhe doli në Dardani, pjesa veriore e Peonisë u bë pjesë e shtetit dardan. Nën pushtimin romak, Peonia u nda midis provincës II dhe III të Maqedonisë. Pas riorganizimit administrativ të Perandorisë Romake, nga Peonia dhe Pellagonia u krijua provinca Maqedonia II (Macedonia Salutaris). Rreth vitit 400 peonët e humbën plotësisht identitetin dhe Peonia mbeti vetëm term gjeografik. (Arben Hajdari)

PEONISHTJA. Gjuhë e peonëve, të cilët jetonin në Maqedoninë e sotme Qendrore-

Lindore, në fqinjësi me makedonët e lashtë dhe dardanët. Disa studiues, si Tomashek e Kreçmer i shihnin si ilirë, të tjerë (Deçev) si trakas. Ndonjë studiues madje i sheh si grekë, me huazime të dukshme nga ilirishtja dhe trakishtja. Mendohet se do të kenë pasur gjuhë të veçantë, por nuk njohim mbishkrime të tyre. Në burime të ndryshme klasike janë evidencuar disa fjalë, emra të njerëzve dhe të vendeve. (Adelinë Selmani)

PERANDORI SAMUIL (997-1014). Pas kryengritjes kundër Bizantit (976), u vu në krye të shteti bullgar (976-1014) me qendër fillimisht në Prespë dhe më pas në Ohër. Këtë të fundit e bëri edhe seli të Patrikanës Bullgare. Nga fundi i shek. X, Samuili ndërmori një sërë ekspeditash ndaj vendeve fqinje, me ç'rast pushtoi temën e Durrësit, Dioklenë (Malin e Zi), një pjesë të Dalmacisë, Bosnjën dhe Rashën. Përveç këtyre vendeve dhe Maqedonisë, deri në këtë kohë, në kuadër të shtetit bullgar u përfshinë edhe pjesa më e madhe e Bullgarisë, Thesalia, tema e Nikopojës dhe Dardania. Në Diokle ai e la në pushtet princin vendës, Gjon Vladimirin, të cilit i dha për grua vajzën e tij, Kozarën. Në Durrës, pas vitit 997 Samuili, bashkëshortja e tij Agata, e cila vinte nga një familje bujare e Krisilëve durrsakë, nuk i preku privilegjet dhe pushtetin e kësaj familjeje. Në trevat e Vlorës e të Beratit perandori bullgar ia besoi komandën Elinagër Frëngut, pinjoll i një familjeje fisnike vendëse. Kështu veproi edhe në Devoll, Kolonjë, Vageneti (Çamëri) etj. Në fillim të shek. XI epërsia i kaloi Bizantit, i cili ripushtoi Shkupin (1004) dhe Durrësin (1005). Perandori bizantin Bazili II (976-1025) i shkaktoi disfatë Samuilin në betejën e Bellasicës (1014). Rreth 14,000 luftëtarë të këtij të fundit u zunë rob dhe u verbuan. Pas vdekjes së Samuilin (1014), shteti bullgar u zhyt në luftëra të brendshme dinastike. Këtë e shfrytëzoi Bazili II, i cili i dha fund ekzistimit të Perandorisë Bullgare (1018). Në Ballkan dhe në viset shqiptare sërish u rimëkëmb pushteti bizantin. (Qerim Dalipi)

PERANDORI SIMEON (893-927). Ishte princ (893-914) dhe perandor (914-927). Themeloi Perandorinë e Parë Bullgare dhe ndërmori ekspedita të suksesshme kundër Perandorisë Bizantine. Ai pushtoi Trakinë, Maqedoninë (deri në Selanik, 904) dhe sulmoi

Greqinë Veriore, duke mbërritur deri në gjirin e Korintit (918). Në vitin 924 pushtoi Rashën, por pësoi disfatë në luftë kundër kroatëve (926). Ndërkohë, me përjashtim të Durrësit dhe të Shkodrës, pushtoi Arbërinë Qendrore dhe Jugore, një pjesë të temës së Nikopojës dhe në verilindje Dardaninë. Pushtimet e Simeonit lanë gjurmë të dukshme në trevat shqiptare, posaçërisht në trevën përgjatë Devollit deri në bregdet. Në krye të krahinave të kësaj zone u emëruan feudalë bullgarë. Në gjysmën e dytë të shek. IX në zonën Ohër-Korçë-Devoll-Berat zhvilloi aktivitetin misionar Klementi i Ohrit, i cili hapi shkolla dhe kisha sllave. Rrjedhimisht, trevat midis Devollit dhe Vjosës hynë nën ndikimin kishtar e kulturor të Ohrit. Pas vdekjes së Simeonit, ra ndjeshëm fuqia e shtetit bullgar. (Qerim Dalipi)

PERANDORIA OSMANE. Perandori militare, e cila në kulmin e fuqisë së saj në fund të shekullit XVI përfshinte një pjesë të madhe të Europës Juglindore, pjesën më të madhe të Lindjes së Afërme dhe pjesën më të madhe të Afrikës Veriore. Nga një emirat kufitar me Bizantin (shek. XIII), shteti osman arriti në fund të shekullit XVI dhe përgjatë shekullit XVII ta fitonte statusin e fuqisë më të madhe botërore.

I quajtur sipas themeluesit të tij, Osmanit I (1301-1326), duke u zgjeruar në dëm të Bizantit të dobësuar, shteti osman fillimisht e vendosi kryeqendrën në qytetin Bursa (1326), pastaj në Edrene (1361) dhe në fund në Stamboll (1453). Sulltanët osmanë nga pasardhësi i Osmanit, Orhani (1326-1362), deri të Mehmeti II Fatih (1444-46 dhe 1451-81) arritën të zgjerohen në pjesën më të madhe të Ballkanit. Pavarësisht se gjatë këtij ekspansioni në Europë osmanët luftuan kundër koalicioneve të shumta të sundimtarëve ballkanikë të ndihmuar nga Papati, Venediku, Perandoria Habsburge dhe Hungaria, fati i Ballkanit dhe i Bizantit u vulos me rënien përfundimtare të Konstandinopojës (Stambollit) në maj të vitit 1453. Nga ky vit e deri në kohën e sundimit të sulltan Sylejmanit I Ligdhënësit (1520-1566), e njohur si "Periudha e zgjerimit" (1453-1579), Perandoria Osmane arriti zenitin e fuqisë dhe zgjerimin më të madh territorial, duke u shtrirë në tri kontinente dhe duke u bërë për një kohë edhe zotëruese e Mesdheut. Pasardhësit e sulltan Sylejmanit I e futën shtetin osman në "Periudhën e deka-

dencës” (1579-1789), duke u përballur me çrregullime të brendshme (kryengritje të rajës, jeniçerëve, spahinjve etj.) dhe me luftëra kryesisht të pasuksesshme kundër koalicioneve të shumta europiane. Gjatë shekullit XVIII, si pasojë e humbjeve territoriale në luftërat kundër Habsburgëve dhe Rusisë, Perandoria Osmane, bashkë me humbjen e territoreve, humbi edhe statusin e fuqisë së madhe.

Në shekullin XIX Perandoria Osmane u përfshi në “Periudhën e shturjes dhe shkatërrimit” (1792-1919). Reformat e Tanzimatit nuk i ndaluan popujt ballkanikë në luftën e tyre për pavarësi kombëtare. Decentralizimi dhe dekompozimi territorial i Perandorisë Osmane, pas Luftës ruso-osmane (1877-1878) dhe Kongresit të Berlinit (qershor-korrik 1878) rezultoi me krijimin e një sërë shtetesh nacionale në Ballkan. Këto rrethana nxitën shfaqjen e nacionalizmit turk, i shprehur nëpërmjet organizatës nacionaliste, e njohur me emrin “Turqit e rinj”, të cilët me revolucionin e vitit 1908 e detyruan sulltanin ta kthente kushtetutën e vitit 1876. Mirëpo, dekompozimi territorial i Perandorisë nuk ndaloi. Si humbëse në Luftën e Parë Ballkanike (1912-1913), Perandoria Osmane u detyrua të hiqte dorë jo vetëm nga Shqipëria, por edhe nga të gjitha territoret ballkanike, deri te vija Enos-Midia, ndonëse në Luftën e Dytë Ballkanike (qershor-korrik 1913) ajo arriti ta rikthente Edrenenë në kufijtë e vet (Paqja e Bukureshtit, korrik-gusht 1913). Në Luftën e Parë Botërore, Perandoria Osmane u rreshtua përkrah Fuqive të Boshtit, ndërkaq faji për disfatën në luftë iu adresua “Turqve të rinj”, të cilët kishin ardhur në pushtet në vitin 1913, pas përfundimit të luftërave ballkanike. Përmbysja e qeverisë së “Turqve të rinj” dhe ardhja në pushtet e liberalëve rezultoi me lidhjen e armëpushimit (Mudros, 30 tetor 1918). Ushtria osmane u obligua të demilitarizohej, ndërkaq fituesit okupuan të gjitha pikat strategjike të perandorisë. Greqia e okupoi Izmirin dhe pjesët perëndimore të Azisë së Vogël, ndërkaq Armenia aneksoi vilajetet lindore, duke nxitur rezistencën nacionale turke. Me Traktatin e Sevres (10 gusht 1920), Perandoria Osmane, krahas reparacioneve, humbte 4/5 e territoreve, ndërkaq në Europë i mbeti vetëm Stambolli me një rrip të ngushtë toke përgjatë Bosforit dhe Dardaneleve, që duhej të demilitarizoheshin dhe të viheshin nën

administrimin e Lidhjes së Kombeve. Greqia fitoi pjesën më të madhe të ishujve të Egjeut dhe Trakinë Lindore, përfshirë edhe Izmirin, Italia fitoi Adanën, Franca fitoi Sirinë dhe Kilikinë, Britania e ruajti protektoratin mbi Egjiptin dhe fitoi mandatin mbi Palestinën. Parashihej edhe krijimi i një rajoni autonom kurd. Mirëpo, nacionalistët turq në vitin 1919 mbajtën kongresin në Sivas, ku u mor vendimi që të gjitha kompetencat shtetërore t'i kalonin Këshillit Presidencial me në krye Mustafa Kemal Pashën. Qeveria e sulltanit u detyrua të tërhiqej. Asambleja e Madhe Kombëtare e Turqisë (Ankara, 1920) zgjodhi Mustafa Kemal Pashën kryetar të qeverisë së re, e pavarur nga Stambolli. Kemalitet e refuzuan Traktatin e Sevres, i cili e bënte të pamundur krijimin e shtetit nacional turk dhe me sukses e vazhduan luftën para së gjithash kundër grekëve, të cilët deri në shtator të vitit 1922 u dëbuan nga Azia e Vogël dhe Trakia Lindore. Pas nënshkrimit të armëpushimit (1922), forcat kombëtare hynë në Stamboll. Asambleja Kombëtare e shpalli shkëputjen e sulltanatit, duke i dhënë fund sundimit 623 vjeçar monarkist osman. Me Traktatin e Lozanës (24 korrik 1923) u revidua Traktati i Sevres, ashtu që Turqisë iu njohën territoret e Azisë së Vogël, si dhe iu kthyen Armenia Lindore dhe Trakia Lindore, afërsisht në kufijtë e sotëm. Ngushticat u demilitarizuan dhe hynë nën sovranitetin e Turqisë. Ankaraja u shpall kryeqytet (13 tetor 1923), ndërkaq më 29 tetor 1923 u shpall kushtetuta e re, sipas së cilës u shpall Republika e Turqisë, si republikë popullore, me kryetar të parë Mustafa Kemal Pashën (nga viti 1934, Atatürk). U mbyllën gjykatat e sheriatit dhe medresetë, si dhe u suprimua kalifati (3 mars 1924), me çka filloi shndërrimi i Turqisë në republikë moderne. (Gazmend Rizaj, Nehat Krasniqi)

PERIKOPEJA E UNGJILLIT PAS MATEUT.

Dorëshkrim shqip me shkronja greke, i cili gjendet brenda një dokumenti greqisht, që ruhet në Bibliotekën Ambroziane të Milanos, në Kodikun Ambrozian 133, me dimensione 15.3 x 23.3, në fletën 63 me dimensione 15 x 13.5. Dokumenti greqisht nuk ka të bëjë me tekstin shqip. Është përkthim çamërisht i fragmentit të Ungjillit pas Mateut (XXVII, 62-66), i cili këndohej, në alternim me tekstin grek, të shtunën e shenjtë. E zbuloi studiuesi Spiridon Lambros (1851-1919) më 1906.

Lidhur me autorin e dorëshkrimit ka mendime të ndryshme. Nuk ka datë, por mendohet të jetë i shekujve XV a XVI. Dokumenti ka rëndësi si dëshmi për kohën, për atë që është dokumenti i parë i shkruar toskërisht. (Rexhep Ismajli)

PERIODIKU PEDAGOGJIK. Publikime (revista, gazeta, buletine, vjetarë etj.), që botohen periodikisht, në të cilët shkruhet për çështje nga fusha e pedagogjisë dhe e arsimit. Fillat e periodikut pedagogjik në gjuhën shqipe lidhen me revistën “Drita-Ditura” (1884-1885), në Stamboll. Në Kosovë filloi me revistën “Përparimi” (1946-1986), si një e përmuajshme politike, ekonomiko-shoqërore dhe kulturore-arsimore. Në këtë të përkohshme u trajtuan edhe çështje nga fusha e arsimit dhe e mendimit pedagogjik. Në vitet 1971-1978, revista “Përparimi” mori fizionomi edhe si revistë arsimore e pedagogjike. Përveç punime e artikujve nga këto fusha, revista kishte edhe rubrika të veçanta, si: “Nga praktika shkollore”, “Nga përvoja pedagogjike”, “Filozofi, pedagogji, histori” etj. Më vonë dolën edhe disa revista të tjera të mirëfillta pedagogjike, siç ishin revistat: “Për prindërit” (1957), “Buletini-Bilten” (1960) i Entit Pedagogjik për Përparimin e Shkollave i KSA të Kosovës, “Shkëndija” (1971), “Libri shkollor” (1971), “Pedagogu-Pedagog” (1985), “Bota e parashkollorit” etj. Përmes punimeve të autorëve të ndryshëm, këto revista ndihmuan në informimin dhe aftësimin profesional të mësimit dhe në avancimin e arsimit kosovar. (Islam Krasniqi)

PERIUDHA LETRARE. Konceptohet si nocion me bazë përtej letërsisë, të historia sociale, e kulturës apo e ideve. Periudha letrare kufizohet në rrafsh historik dhe dominohet nga klasë tipare, gjinish letrare, autorësh e veprash konkrete, të lidhura në kohë, prandaj periudha është term tipik historiko-letrar që lidhet drejtpërdrejt me periodizimin e letërsisë dhe kthehet në kategori themelore të historisë letrare. Si e tillë, periudha, së pari, është një çështje e teorisë letrare, e përkufizimit të saj si kategori, pastaj e historisë letrare, si kategori e aplikueshme nga ana e historisë. Ajo është përcaktuar si kohë e matshme apo e identifikueshme me fenomene letrare, si: drejtimet letrare, shkollat letrare, lëvizjet letrare, zhanret dominante të një epoke etj. Kështu, ajo përkufizohet e lidhur me epoka

kulturore e ideologjike e me fenomene të brendshme të letërsisë, me pretendimin për t’u universalizuar, por që provën e ka te letërsinë e veçanta, meqë janë vetë letërsinë që shfaqen ndryshe nga njëra-tjetra e që periudhat nuk i përjetojnë njëkohësisht etj. Letërsia shqipe ka histori atipike, e cila, si histori e brendshme e saj, bëhet tipike për të. Historia letrare shqipe e skajon letërsinë e vjetër shqipe, të Rilindjes, letërsinë moderne e bashkëkohore, si periudha (epoka) historike, sociale dhe letrare. Vetë termat burojnë nga më shumë se një fushë e nga më shumë se një kriter, ndërsa historia autentike letrare shqipe kërkon klasifikim autentik. Letërsia e vjetër shqipe, vërtet është letërsia e shekujve XVI-XVIII, e provuar me një korpus veprash, me tipare letrare e shkrimore në shkallë konstantash, por edhe me ndryshime, dhe identifikohet me autorë, si: Gjon Buzuku, Pjetër Budi, Jul Variboba, Muhamet Kyçyku-Çami etj. dhe përfaqësohet nga autori i epokës, Pjetër Bogdani, me veprën “Çeta e profetëve” (1675-1685). Kjo periudhë shenjohe nga tema biblike, diskurse biblike, strukturim tekstesh me tekste e shkrimtarë që shenjon ide të autorit, pastaj hapet në poetikat e Lindjes, me vjershëtarët. Vjershëtarët i shkruan temat sociale e personale me alfabet arab, në poetikat e Lindjes, deri te divani, si formë e ndërliqshme poetike. Letërsia shqipe e Rilindjes, e shekullit XIX, ka autorë themelorë Jeronim de Radën e Naim Frashërin dhe ideolog të provuar (me shkrim) Sami Frashërin. Rilindja shqiptare provohet në letërsi me autorë misionarë dhe në jetën politike me lëvizje e prijës nacionalë. Letërsia shqipe e Rilindjes kthehet në fushë kulturore që merr e jep me lëvizjen nacionale, prandaj veprat e mëdha të saj u bënë edhe vepra të mëdha të mësimin nacional. Ndërsa letërsia moderne shqipe e ktheu mësimin nacional në aktivitet letrar, në aventurën e re të letërsisë shqipe krahas letërsive të tjera. Autorë, si: Faik Konica, Lasgush Poradeci, Ernest Koliqi, Mitrush Kuteli, Migjeni etj., shenjua frymën e re të kulturës shqiptare dhe letërsinë e lidhur me temat e me dhimbjet personale, si dhe letërsinë e temave të mungesave sociale. Moderniteti letrar shqiptar lidhet me letërsinë e formave të kërkuara, me tekstin atributiv e me destinimin e tekstit. Ndërsa letërsia e Kosovës e njohu modernitetin e autorëve që jetuan e që shkruan në Kosovë gjatë gjysmës së dytë të shekullit XX. Formë e madhe u bë proza,

përkrah poezisë që merr pjesën më të madhe të letërsisë shqipe. Pothuajse e gjithë letërsia e Kosovës lidhet me një periudhë kohore (gjysma e dytë e shekullit XX), por tipologjikisht përdëgëzohet e provohet në variante, ndërsa, e lidhur me autorë themelorë, dominohet nga veprat letrare moderne. Kjo letërsi i ka vetitë e veta autenike poetike e historiko-letrare, të cilat duhet të përshkruhen tipologjikisht e të sistemohen historikisht, si letërsi me shenjat e veta e të trashëguara. (Kujtim M. Shala)

PERIUDHA PARAURBANE DARDANE.

Fazë e zhvillimit të shoqërisë dardane gjatë shek. VI-IV p.e.r. Karakterizohet me diferencimin e shoqërisë, të udhëhequr nga aristokracia fisnore dhe njihet edhe si udhëheqje e demokracisë ushtarake. Gjurmët e diferencimit shoqëror janë të dukshme në paraqitjen e akropoleve në vendbanimet kodrinore, në mënyrat e llojlojshme të banimit, në punimet e organizuara për rrafshimin e tarracës II në Gadimen e Epërme, si dhe në paraqitjen e zëjtareve poçarë, që përdornin çarkun, përbërjen e llojlojshme të kulturës materiale etj. Fuqizimin dhe pasurimin e shtresës së aristokracisë fisnore nga shekulli VI p.e.r. e dëshmon dhe tuma luksoze e Banjës së Pejës me importe atike të enëve me figura të zeza (olpa, kupa-skifose). Në këtë periudhë u paraqitën dhe elemente më të përparuara arkitektonike, siç ishte prodhimi i tullave në trajtë elipsoide dhe i përforcimeve prej gurësh të shtyllave prej druri.

Pos xehetarisë dhe metalurgjisë, bashkë me bujqësinë e blegtorinë, u zhvilluan edhe disa degë zëjtare dhe tregtia më intensive. Zëjtaret prodhonin stoli, qeramikë, armë dhe vegla pune. Duket se prodhime të tyre ishin stolitë prej argjendi (byzylykë, unaza) dhe tri përkrenare ilire prej bronzi nga varri luksoz i Banjës së Pejës, si dhe dy përkrenare të tjera ilire nga Korisha dhe një e Dejës. Prodhime vendore janë edhe sëpatat dytehtëshe (labrys) nga tumat e Romajës e Shirokës. Për prodhimet dardane prej ari të njohura jashtë trojeve dardane, flasin dhe burimet e mëvonshme të shkruara, si dhe për djathin dardan. Poçaria u zhvillua falë përdorimit të çarkut të poçarit, sikundër që edhe trajtat e llojlojshme helene u përvetësuan me lehtësi, ndërkohë u ruajtën dhe disa trajta vendëse. Trajtat e llojlojshme të qeramikës janë tregues i ngritjes së nivelit të jetës dhe i nevojave të zgjeruara të shoqërisë dardane,

që përfshijnë dhe skifosët, kilikët, kantarosët, hidriat, lekanët, olpat, kraterët, amforat dhe pitosët e madhësive të ndryshme, të atyre të përdorimit shtëpiak dhe për transport.

Periudha paraurbane dardane është pjesë e zhvillimit të Fazës dardane II (VIII-IV p.e.r.), përkatësisht nënfazës b dhe c. Nënfaza b (shek. VI- V p.e.r.) karakterizohet me zgjerimin e vendbanimeve edhe rrëzë kodrave, si dhe me trajta të reja të enëve të punuara me dorë, siç janë enët me vegje në trajtë kalemi dhe enët e thella me vegje që dalin nga buza e enës në trajtë gjuhe të zgjatur, me të cilën ndërlihdhet në kënd të drejtë vegja me prerje rrethi. Risi është dukja e qeramikës së punuar me çark të poçarit, kryesisht sipas modeleve helene. Qeramika ka pjekje të kuqërremtë, të murrmë, okër dhe, më vonë, gri. Risi është dhe qeramika e pikturuar, kryesisht e amforave dhe hidriave. Ka dhe objekte të importuara helene, në mesin e të cilave veçohen qeramika atike me figura të zeza nga Banja e Pejës, ena me mbishkrim unik me alfabet arkaik grek (Gadime e Epërme: shek. VI p.e.r.) etj.

Nënfaza c (mesi i shek. V deri në mesin e shek. IV p.e.r.) shënon fuqizimin dardan dhe nga fundi i saj braktisjen jo të dhunshme të vendbanimeve kodrinore dhe vendosjen në rrafsh. Në këtë fazë dominon qeramika e punuar me çark, e ngjashme me parapraken. Nga fundi i nënfazës mbisundon qeramika gri, që tregon se nis zbatimi i një teknologjie më të avancuar se më parë. Importi u bë më i rrallë për shkak të krizave në botën helene dhe në vend të tij u rrit prodhimi vëndës. Qeramika u punua sipas modeleve të qeramikës me vernik të zi të rrethit atik, ndërsa nga qeramika e importuar është e pranishme ajo e grupit "Saint Valentin", e stilit "Wave-Line" etj. (Edi Shukriu)

PERJUCI Xhevat (1949-). Inxhinier i makinërisë, profesor universiteti. Lindi në Deçan, ku kreu edhe shkollën fillore. Shkollën e mesme e kreu në Mitrovicë, ndërsa Fakultetin e Makinërisë në Sarajevë (1973). Studimet pasuniversitare i kreu në Universitetin e Beogradit, ndërsa disertacionin e mbrojti në Prishtinë (1988). Punoi si mësimdhënës në Qendrën Shkollore Teknike "19 Nëntori" në Prishtinë, kurse më 1977 u zgjodh asistent në Fakultetin Teknik të Universitetit të Prishtinës dhe më pas avancohet në tituj të tjerë univeritarë, (profesor ordinar, 1998). Kreu detyra dhe funksione



XHEVAT PERJUÇI

dhe bashkautor ka botuar një sërë punimesh shkencore në revista të ndryshme. Përveç punës shkencore dhe pedagogjike në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike, ka mbajtur ligjërata edhe në Fakultetin e Elektroteknikës, në Shkollën e Lartë Pedagogjike dhe në Fakultetin e Xehetarisë dhe të Metalurgjisë në Mitrovicë. (Musli Bajraktari)

PERKAJ Milan (1922-1996). Historian, mësimdhënës. Lindi në Fundëna, Tuz, Mali i Zi. Pas fillores, shkollimin e vazhdoi në gjimnazin e Podgoricës, për të diplomuar në gjimnazin e Prishtinës (1943). Mbaroi studimet për histori në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Zagrebit (1953). Nisi punë si sekretar i komunës së Hotit dhe mësues i shkollës fillore në Arzë të Hotit. Pas përfundimit të studimeve, mbajti mësim në shkollën tetëvjeçare të Tuzit, pastaj ishte profesor në Shkollën Normale të Prizrenit. Punoi edhe në Inspektoratin e Arsimit në Prishtinë, ndërsa më 1958 u zgjodh drejtor i Shkollës së Mesme Teknike në Mitrovicë, ku punoi për 16 vjet me radhë. Në periudhën 1974-1977 ishte drejtor i Shkollës së mesme teknike “Nikolla Tesla” në Obiliq. Ishte ndër bashkëpunëtorët e parë të revistës “Përparimi”, ku botoi punime të ndryshme. M. Perkaj ishte edhe bashkautor i tekstit shkollor “Pasqyra e historisë nacionale shqiptare” (1960), teksti i parë i historisë së popullit shqiptar për nxënësit shqiptarë në Kosovë, në Maqedoni dhe në Mal të Zi. (Ali Lllunji)

PEROVIQ Budimir (Perović) (1904-1987). Studiues arbnes, shkrimtar. Lindi në Arbanas (Arbnesh) të Zarës. Kreu shkollimin fillor e të mesëm në Zarë, në Dubrovnik dhe në Vërshac të Serbisë. Ishte mësues në vende të ndryshme, punonjës i kulturës në Zarë dhe sërish arsimtar i matematikës, tani në Arbanasi. Ka shkruar artikuj mbi gjuhën në revistat “Jeta e re” e “Përparimi” dhe në gazetën

“Rilindja” në Kosovë. Mes tjerash ka shkruar artikujt: “Nji shikim për trajtat e futurit në të folmen e Arbëneshëve të Zadrës” në “Jeta e re” (1954) dhe “Foljet ndihmetare në të folmen e arbëneshëve të Zadrës” në “Përparimi” (1980), ribotuar në “Studime filologjike” në Tiranë një vit më pas. (Bardh Rugova.)

PERSONAZHE TË EPOSIT TË KRESHNIKËVE. Heronjtë e këngëve kreshnike, bartësit e bëmave kryesore të rrëfimit epik, në shëmbëlltyrën e të cilëve mishërohen vlerat morale të protagonizmit kalorësiak. Personazhe kryesore të këtij eposi janë:

Çeto Basho Muji: është kreshniku kryesor, prijës i çetës së tridhjetë kreshnikëve. Çeta e tij është mbrojtje nga shkiqet, që hynin pa leje në zotërimet e kreshnikëve. Ai ka fuqi mitike nga qumështi i zanave, ka miqësi me Orën dhe Zanën, ka trup të përmasave hiperbolike. Është kreu i familjes, jeton në kullë, e dëgjon nënën, pret miq e shokë sipas rregullave të mikpritjes shqiptare. Peshon fjalën, nderon bashkëbiseduesin, u del zot shokëve dhe krahinës. Me armiqtë është sa i matur, aq edhe i rreptë, nuk u shmanget dyluftimeve dhe del fitimtar. Është simbol i trimërisë, i guximit dhe i qëndrësës. Ndeshet me mbretër, kapidana, harambashë etj. Lufton për ta ruajtur bashkësinë e lirë fshatare.

Sokol Halili: është vëllai më i ri i Mujit, që merr pjesë në çetën e drejtuar nga i vëllai. Është njëri nga shtatë Halilat, Halili i shtatë, trim i madh, guximtar i pashoq, i fuqishëm, djalë i pashëm, simbol i trimërisë, i adhuruari i vajzave të mbretërive: Tanusha e Kotorrit, Dylber Angjelina, Tankosa e Bardhë etj. I nderon si motra të gjitha vajzat e krahinës. Ka miqësi me qenie mitike: Zanën e Orën. Kur është nevoja, e marrin ndore edhe hëna e dielli. Me armiqtë është sa i matur, aq edhe i rreptë, ashtu si Muji. Në dyluftime del fitimtar. Ka besë dhe jep ndore. Ka tipare etnopsikologjike të shqiptarëve si etni, njësoj si Muji dhe pjesëtarët e çetës së tij.

Kreshnikët e tjerë: Tal Budalina, Ali Bajraktari, Arrnaut Osmani, Ager Isvano, Zuko Bajraktari, Dezdar Osman Aga, Ramë Bajraktari, Deli Rizvan Aga, Hysen Aga i Ri, Haxhi Mehmet Aga, Uçiçe Hyseni, Beno Bajraktari, Gjidi Brahimi etj., si dhe vajzat kreshnike, Bardhja e Bardhë, Fatimja e Bardhë, Çika e Herrni Mustafë Agës etj., e konsiderojnë vdekjen në

luftë si vdekjen më të denjë. Disa prej tyre janë figura tipike përfaqësues të tipareve dhe të karaktereve të veçanta, si p. sh.: Tal Budalina, Dizdar Agë Osmani etj.

Kundërshtarët e tyre: Krali i Kotorrit, Krali i Sejës, Krali i Zadarit, Krali i Budimit, Krali i Talirit, Krali i Miskovit, Krali i Bagdatit, Gavran Kapetani, Galan Kapetani, Stojan Kapetani, Millosh Kapetani, Sejan Kapetani, Gjyre Harambashi, Paun Harambashi, Vuke Harambashi, Filipe Maxharri, Mihajl Maxharri, Uroshi i Zi, Ganiqe Galani, Harap Zullumqari, Bajlozi i Zi, Harapi me Tre Krena etj. të gjithë janë trima, e disa kanë edhe fuqi mitike. Kanë miqësi me orët dhe me zanat e veta; janë të guximshëm, të shkathët, por edhe të pabesë. Ata i sulmojnë kullat e kreshnikëve dhe i djegin; prekin në nderin e familjes së kreshnikut: ia marrin motrën ose gruan; lypin mejdane dhe i pranojnë duelet, sipas rregullave. Edhe kuajt e tyre u ndihmojnë në mejdane. Përdorin armët, si kreshnikët tanë: xhiliti, topuzi, shpata, thika. (Zymer U. Neziri)

PERSONAZHET E ANEKDOTAVE. Shquhen për aftësi të theksuara kreative, në gjetjen e zgjidhjeve për situata të caktuara. Personazhet janë kryesisht altruistë, përkrahës të së bukurës kundruall të shëmtuarës, të mirës kundruall së keqes. Në angazhimin dhe sendërtimin e mesazhit të tyre nuk vepron forca magjike, por shkathhtësia e mendimit dhe gjetja e zgjidhjes së përshtatshme për situatën e caktuar. Në anekdota ka personazhe pozitive dhe negative, humoristike dhe satirike, të cilat veprojnë shpesh në mënyrë të dyanshme, varësisht për çka angazhohen dhe cili është mesazhi kryesor që u drejtohet të pranishmëve. Në anekdotat popullore shqiptare hasen personazhe të përgjithshme, si: Nasradin Hoxha, Tosku e Mosku, Qosja, Qeli etj., rrëfimet për të cilët i karakterizon humori dhe satira, si dy elemente qenësore të tekstit, që misionin e tyre e bëjnë të kapshëm, të pranueshëm dhe të dashur për dëgjuesin. Personazhet më të njohura në anekdotat popullore në Kosovë vijnë nga Drenica: Dervish Goxhuli, Xhemail Obria, Ramadan Shabani, Mujë Loshi, por edhe Sahit Bakalli nga Gjakova. (Adem Zejnullahu)

PERSONAZHET E BALADAVE. Kanë veçori karakteristike që i dallojnë nga personazhet e llojeve të tjera të poezisë epike legjendare dhe

historike. Veprimet e tyre lidhen ngushtë me misionin etik dhe me botën emocionale, prandaj brenda poezisë popullore karakterizohen si personazhe-ide. Duke qenë konsekuent në bindjet e tyre për të cilat angazhohen me tërë qenien, bëhen shumë shpesh viktimë e fajit tragjik të kushtëzuar edhe nga bota emocionale, si pasojë e konfliktit me mjedisin e caktuar ose nga kushtëzimi i qenieve mitologjike. Botën e tyre e karakterizon observimi i brendshëm, brenda konfliktit midis jetës dhe vdekjes, në të cilin mbizotëron kulti i jetës, i vazhdimësisë së saj nëpërmjet formave të metamorfozimit në qenie të tjera bimore apo shtazore, siç ndodh në motivin e baladave të vëllait të vdekur, apo në baladat e dashurisë së pafat si në poezinë e arbëreshëve të Italisë, ashtu edhe në variantet e ndryshme të Kosovës e të viseve të tjera shqiptare. Personazhet e shumicës së baladave (duke përfshirë baladat historike) mbesin gjysmanonime dhe paraqiten me kuptime të përgjithshme në marrëdhënie familjare, si nëna, vëllai, motra ose edhe me emra të pidentifikueshëm, si: vasha e trimi, Konstandini (i Vogëlith), Garentina, Begzadja e Bardhë, Halil Garria, Aga Ymeri, Çika Potureshë, Çobanësja, Gjelina, vëllai i vogël, nusja, vjehrra etj. Në shumicën e rasteve këto personazhe nuk paraqiten fare me pamjen e tyre të jashtme, as me veshje e stoli karakteristike. Bukuria e tyre i përket sferës shpirtërore dhe është shpesh shkaktare e fatit tragjik. Personazhet e baladës i karakterizon kuptimi gjithëkohor i kronologjisë së ndodhive dhe hapësira e papërcaktuar e ngjarjeve. (Sadri Fetiu)

PERSONAZHET E EPIKËS LEGJENDARE. Janë njerëz me fuqi të jashtëzakonshme fizike dhe shpirtërore, të marrë nga qeniet mitike, më së shpeshti nga orët dhe zanat, apo me vlera të veçanta etnopsikologjike, si: besa, burrëria dhe nderi. Kanë besim në fuqinë e tabuve të ndryshme, të totemeve natyrore, në fuqinë e trupave qiellorë (Dielli dhe Hëna), në fuqinë ktonike të tokës, si dhe të fajit të paracaktuar tragjik etj. Kjo fuqi e personazheve manifestohet edhe nëpërmjet hiperbolizimeve dhe veprimeve të tjera mitike e magjike, por ato janë shpesh edhe vetë qenie të jashtëzakonshme të besimeve tradicionale popullore, si orë, zana, kuçedra, diva, njerëz të shenjtë etj. Funkcionet hiperbolizuese të personazheve të këngëve

epike legjendare, si edhe veprimet e tjera, si: metamorfozimi, tejkalimi i kufizimeve, midis të cilave është edhe vdekja, flasin për synimet e njerëzve të rëndomtë, krijuesve dhe adhuresve të artit popullor, për t'i përballuar vështirësitë e pengesat, për ta mundur të keqen, madje edhe vdekjen, me qëllim që të përmbushen obligimet e detyrueshme morale. Situatat e mrekullishme, qoftë si ndodhi të rastit me pasoja të vazhdueshme, siç është rrjedhja e gjirit të gruas së muosur, qoftë edhe si metamorfozime, siç ndodh në baladat e dashurisë së pafat, kanë kryesisht funksion artistik. (Sadri Fetiu)

PERSONAZHET E PËRRALLËS. Janë herojnë të përrallave, të cilët bëjnë veprime që kufizohen me mrekullitë. Heroi i përrallës është shpesh fëmijë i prindërve që nuk kanë pasur fëmijë ose vëllai apo motra më e vogël. Personazh ndihmës mund të jetë njeriu i rëndomtë, apo ai me veti mitike, figurat mitologjike, pastaj kafshët, insektet dhe objektet e ndryshme. Heroi udhëhiqet me këshilla, dhurata, më pak me impulse emocionale, por edhe me vendime të veta të vetëdijshme. Në përrallë personazhet janë tipike: njëri vëlla është i marrë, tjetri i mençur; njëra motër është e vyeshme, tjetra përtaçe; njëra është e bukur, të tjerat të shëmtuara. Në shumë përralla shfaqen tre vëllezër apo tri motra, ndërsa rolin e kryepersonazhit e merr vëllai më i vogël, apo motra më e vogël. Heroi nuk emërtohet, por është djali i vogël i mbretit, apo djali i një plake, vajza e mbretit etj., prandaj dhe përrallat kanë tituj tipikë, si: “Vajza e mbretit dhe gjarpri”, “Djali i mbretit” etj. Në përrallë nuk ka emra të përveçëm. Pengesat apo peripecitë heroit i tejkalon me ndihmën e mbështetësve, por edhe me gjindshmërinë e vet. Personazhi e krijon identitetin personal, e arrin pjekurinë emocionale edhe e gjen partnerin me të cilin do të jetë i lumtur. Rol të veçantë në rrafshin përmbajtësor dhe emocional ka vajza e bukur, sidomos e Bukura e Dheut, figurë mitologjike e përrallës shqiptare. Rreth kërkimit të saj ndërtohet subjekti i shumë përrallave, por funksion të rëndësishëm kanë edhe shumë figura të tjera mitologjike, si: kuçedra, dragoi, llamia, lubia, shtatë pllamë mjekër tre pllamë shtati, orët, roja e shtëpisë, zanat etj. (Myzafere Mustafa)

PERTUSI Agostino (1918-1979). Historian, bizantolog, profesor universiteti. Studimet i bëri në Universitetin Katolik të Milanos, ku dhe u diplomua për letërsi klasike (1941). Në vitin 1952 bëri botimin e parë kritik me komente dhe parathënie të veprës “Mbi Themat” të Konstandin Porfirogenetit. Nga viti 1952 Pertusi nisi të punonte në Fondacionin “Giorgio Cini” në Venecia, ku realizoi projekte kushtuar marrëdhënieve të Venedikut me Bizantin, në mbështetje të burimeve venedikase. Më pas kontributet e tij në fushën e bizantologjisë i bëri të ditura në rrethe shkencore ndërkombëtare. Ishte gjithashtu i interesuar edhe për historinë mesjetare shqiptare, dhe në këtë kontekst ka ofruar të dhëna të panjohura sidomos për Kosovën mesjetare në veprën e postume “Martin Segoni i Novobërdës, ipeshkëvi i Ulqinit” (1981) dhe më parë në studimin “Mbi historinë e Ulqinit në shek. XIV-XV dhe statutet e tij qytetare” (1975). (Jahja Drançolli)

PERUNOVIQ Mirko (Perunović) (1938-). Jurist, profesor universitar. Lindi në Drenovshiticë të Nikshiqit në Mal të Zi. Gjimnazin dhe Fakultetin Juridik i kreu në Prishtinë, studimet pasuniversitare në Universitetin e Shkupit, ku edhe doktoroi në vitin 1985. Në vitin 1970 u zgjodh asistent për lëndën e drejta ekonomike për mësim në gjuhën serbokroate dhe po në këtë fakultet vazhdoi karrierën universitare. Ishte aktivist në organet e LKJ-së, në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës dhe në Komitetin Komunal të Prishtinës. M. Perunoviçi ishte caktuar në krye të organit drejtues të përkohshëm në Universitetin e Prishtinës, me të cilat Serbia kishte vendosur masat e dhunshme në këtë institucion. Me nënshkrimin e tij ishin lëshuar aktvendime, me të cilat stafit pedagogjik të Fakultetit Juridik për mësim në gjuhën shqipe iu ndërpre marrëdhënia e punës, e bashkë me këtë edhe ndërprerja e studimeve në gjuhën shqipe. (Ejup Sahiti)

PESHKOPI ARTEMIJE (Marko Radosavljević) (1935-). Titullar i Kishës Serbe, peshkop i Rashkës dhe Prizrenit, i shkarkuar në vitin 2010 nga Sinodi. Lindi në fshatin Leliq në Valevë, Pas përfundimit të Fakultetit Teologjik në Beograd, kreu studimet pasuniversitare në Athinë. Më pas është tërhequr në Manastirin “Cërna Reka”, ku kaloi 13 vjet. Sinodi i Kishës

Ortodokse Serbe e shkarkoi nga udhëheqja e peshkopatës së Rashkës dhe të Prizrenit me shpjegimin se ka bërë keqpërdorime financiare, por prapavija duket të ketë qenë politike. Nga ajo kohë jeton në Manastirin Shishatovac të Frushka Gorës. Pavarësisht se i është marrë titulli i peshkopit dhe ka titullin e murgut të zakonshëm, Artemije paraqitet si “peshkopi i Rashkës dhe i Prizrenit në ekzil” dhe, së bashku me mbështetësit e tij, kryen liturgji në Kishën e Shën Jovanit në fshatin Ljuljac në Shumadi (Serbi). (Qemajl Morina)

PESHKOPI TEODOSIJE (Živko Šibalić) (1963-). Titullar i Kishës Serbe, peshkop i Rashkës dhe i Prizrenit. Lindi në Çaçak. Pasi përfundoi shkollën fillore dhe të mesme në Gorjani dhe Uzhicë, vazhdoi studimet për fe në Fakultetin Teologjik të Beogradit. Rishtar u emërua në vitin 1987, në Manastirin “Cërna Reka” në Novi-Pazar kur ka nisur jetën si murg nën udhëheqjen e igumenit Artemije. Më pas shërbeu në Kishën e Shën Gjergjit në Prizren dhe në Manastirin Qelija në Valevë. Nën udhëheqjen peshkopit Artemije dhe të priftit Teodosije si kryemurg, Manastiri i Deçanit u bë manastiri më i madh mashkullor i Kishës Ortodokse Serbe. Peshkop i Rashkës dhe Prizrenit u emërua në dhjetor të vitit 2010. (Qemajl Morina)

PETRIÇ Wolfgang (Wolfgang Petritsch) (1947-). Diplomati austriak me përkatësi etnike slovene. Lindi në Klagenfurt (Austri). Studioi historinë, gjuhë gjermane, shkencë politike dhe drejtësi në Universitetin e Vjenës. Gjatë viteve 1977-1983 ishte bashkëpunëtor i kancelarit austriak Bruno Krajski, më pas ambasador i Austrisë në Beograd (1997-1999). Gjatë kësaj kohe u emërua edhe përfaqësues special i Bashkimit



VOLFGANG
PETRIÇ

Europian (BE) për Kosovën. Pak kohë pas ngjarjes së Reçakut, V. Petriç përgatiti një katalog parimesh, të cilët do të përbënin bazën për bisedimet e ardhshme në Rambuje për statusin kalimtar të Kosovës. Atij i takon merita për idenë e përfshirjes edhe të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës si palë negociuese në Konferencën e Rambujesë. Si përfaqësues i lartë për Bosnjë e

Hercegovinë (1999-2002), kryesoi implementimin civil të Marrëveshjes së Paqes të Dejtonit. Është autor ose bashkautor i disa librave, ndër të cilët: “Kosovo-Kosova: Mite, data, fakte” (në bashkpunim me Karl Kazerin dhe Robert Pichlerin, 1999) dhe “Bosnja dhe Hercegovina: Nga Dejtoni deri në Europë” (2002). Në qershor të vitit 2013 Universiteti i Prishtinës i dha titullin “Doctor Honoris Causa”. (Sylë Ukshini)

PETROTA (Petrotta) Gaetano (1882-1952). Albanolog, filolog italian. Historian i letërsisë dhe profesor i filologjisë bizantine nga Hora e Arbëreshëve në Sicili. Prift në kishën e Horës.



GAETANO
PETROTA

Me punimin “Sprovë e fonetikës krahasimtare të gjuhës shqipe” (1924) u nderua me çmim nga Akademia italiane Lincei. Vepra e tij kryesore mbahet “Populli, gjuha dhe letërsia shqipe” (Popolo, lingua e letteratura Albanese, 1931),

ku parashtroi një vështrim të përmbledhur të historisë së letërsisë, bashkë me një histori mjaft të pasur të studimeve albanologjike për çështje të alfabetit, të gramatikës, të dialektologjisë, të leksikografisë, të historisë së gjuhës, të etnografisë, të folklorit dhe të historisë së kulturës. Vepra të tjera të Petrotës janë: “Sprovë për bibliografinë shqipe, 1500-1930” (Saggio di bibliografia albanese 1500-1930, 1931); “Letërsia shqiptare dhe italo-shqiptare” (Letteratura albanese e italo-albanese, 1939); “Zhvillimi historik i kulturës dhe i letërsisë shqiptare” (Svoglimento storico della cultura e della letteratura albanese, 1950); “Çështje etnike-gjuhësore greke-shqiptare” (1950). Botoi edhe analiza filologjike të teksteve të vjetra të shqipes dhe një studim mbi një katekizëm shqip redaktuar nga M. Markiano, si dhe analizoi disa pjesë të “Mesharit” (1555) të Buzukut, pasi më parë i kishte botuar me P. Skiroin. U mor edhe me jetën e veprën e Bogdanit. La dorëshkrim një gramatikë shqipe të së folmes së Horës së Arbëreshëve (1938) dhe një fjalor frazeologjik të arbëreshëve të Sicilisë (1942). Mbajti gjallë aktivitetet kulturore shqiptare në Sicili, sidomos nga viti 1937, si redaktor i revistës “Fjala e t’Inzoti” themeluar nga P. Skiroi dhe i “Rivista italo-albanese” që e drejtoi me të vëllanë. Ishte anëtar i Institutit Mbretëror të

Studimeve Shqiptare në Tiranë, anëtar në Istituto di Studi Adriatici di Venezia, anëtar i Akademisë së Shkencave të Palermos dhe sekretar i Ligës Italo-Arbëreshe. Më 1932 themeloi katredrën e gjuhës dhe të letërsisë Shqipe në Universitetin e Palermos. (Shpëtim Elezi)

PETROVA. Fshat në komunën e Shtimes, rreth 3 km në jug të qytezës, shtrihet rrëzë maleve të Jezercit. Territori i fshatit ka sipërfaqe prej 13 km². Gjetjet e shumta arkeologjike dhe toponimet dëshmojnë për lashtësinë e këtij vendbanimi. Me emrin Petre është regjistruar në sallnamet e Vilajetit të Kosovës të vitit 1893. Në vitin 1948 kishte 887 banorë, ndërsa në vitin 2011 ka 2,543 banorë. Popullsia merret me bujqësi dhe blegtori. Është seli e bashkësisë lokale, ku gravitojnë fshatrat: Topillë, Devetak, Llanishtë dhe Mollopolc. Nga objektet e standardit shoqëror ka shkollën, zyrën e vendit, qendrën e mjekësisë familjare, shkollën 9-vjeçare, disa njësi tregtare etj. (Shpend Agaj)

PETROVCI Enver (1954-). Aktor, mësimdhënës universitar. Lindi në Prishtinë, ku kreu shkollën fillore dhe gjimnazin. Mbaroi studimet për aktrim në Shkollën e Lartë Pedagogjike



ENVER PETROVCI

(1972) në Prishtinë. Në Beograd kreu aktrimin në Fakultetin e Arteve Dramatike (1978). Me shfaqjet “Mblesëria” dhe “Martesa” të A. P. Çehovit, si student, mori pjesë në të gjitha festivalet e ish-Jugosllavisë, si dhe në disa festivale ndërkombëtare. Pas diplomimit punoi në Teatrin Jugosllav të Dramës. Në “Atele 212” luajti rolin kryesor në shfaqjen “Kurora e Kosançiqit”. Pas kësaj shfaqjeje, në vitet ’80 u angazhua kryesisht në rolet kryesore teatrore. Me thellimin e krizës në ish-Jugosllavi, u largua nga Beogradi dhe në Prishtinë luajti shfaqjet “Konfiteori”, “Procesi” dhe “Nastasja Filopovna”. Ndërkohë u angazhua në disa teatro të rëndësishme, si në Dubrovnik, në Suboticë, në Novi-Sad etj. Në fillim të viteve ’90 u zgjodh ligjërues i aktrimit dhe i diksionit në Fakultetin e Arteve në Prishtinë. Në vitet 1990-1993 ishte themelues dhe drejtor i Teatrit “Dodona” në Prishtinë. Pas largimit nga puna në Teatrin “Dodona”, në vitin 1994 themeloi shkollën

e parë private të aktrimit “Actor’s Studio” në Prishtinë. Më vonë, në vitet e pasluftës, nga kjo studio themeloi Akademinë e Arteve dhe më pas shtëpinë teatrore “Teatri i Babës”. Luajti një numër të madh rolesh teatrore dhe në dhjetëra filma, seriale dhe drama televizive, kryesisht në role kryesore. Shfaqjet “Kush më ka faj që jam shqiptar” dhe “Të mallkuarit”, në të cilat ai është autor, regjisor dhe aktor, ishin shfaqjet e para që u realizuan në Teatrin “Dodona” dhe në Teatrin Kombëtar të Kosovës menjëherë pas luftës në Kosovë. Në mesin e roleve kryesore në filma dhe seriale televizive, do veçuar “Kur pranvera vonohet” (1980), “Dhembja krenare” (1990) dhe “Rojat e mjegullës” (1988). U shpërblye me shumë çmime si në festivalet teatrore më prestigjioze të ish-Jugosllavisë, ashtu edhe në ato në Kosovë, para dhe pas luftës (1999), prej të cilave do veçuar: çmimi i parë në Festivalin Mbarëkombëtar “Aleksandër Moisiu” Tiranë (1993), aktori më i mirë në Festivalin e Filmit Kosovar (2003 dhe 2004), aktori më i mirë protagonist në Festivalin e Teatrove të Kosovës (2007) dhe aktori më i mirë në Tiranë Internacionl Film Festival (2010). Krahas aktivitetit artistik, punon edhe si pedagog në degën e aktrimit të Fakulteti i Arteve të Universitetit të Prishtinës. (Besim Rexhaj)

PETROVIQ (Petrović) Petar (1938-1997). Filolog serb. Lindi në Beograd dhe u shkollua në Kralëvë, Nish e Beograd. Diplomoi në degën e filologjisë klasike të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Beogradit (1960), ku më pas kreu studimet pasuniversitare dhe mbrojti tezën e disertacionit “Paleografia e mbishkrimeve romake në Mezinë e Epërme” (1971). Punoi në Muzeun Popullor të Nishit (1962-1971) dhe vazhdoi punën në Institutin Arkeologjik në Beograd. Botoi veprat “Paleografia e mbishkrimeve romake në Mezinë e Epërme”, “Nishi në periudhën antike”, “Mediana, rezidenca e mbretërve romake” (1994) dhe bashkautor i veprave kapitale “Mbishkrimet e Mezisë së Epërme IV” (1979) e “Mbishkrimet e Mezisë së Epërme III/2 Timacum Minus dhe të Luginës së Timokut” (1995). (Edi Shukriu)

PEZA Myrteza (1919-1981). Shkrimtar, dramaturg, gazetar. Lindi në Elbasan, ku kreu shkollën normale. Studioi në Firence (Itali). Pas Luftës së Dytë Botërore u shpërngul në Maqedoni dhe punoi si mësues në Gostivar dhe

rrethinë. Më 1946 qe redaktor i emisioneve në gjuhën shqipe në Radio Shkupi, kurse më pas redaktor përgjegjës dhe drejtor i gazetës “Flaka e vëllazërimit”. Në vitin 1962 themeloi revistën letrare-shkencore “Jehona”, të cilën e drejtoi deri më 1968. Po këtë vit kaloi sërish në Radio Shkup, si udhëheqës i programeve në gjuhën shqipe dhe turke. Nga ajo kohë programi në gjuhën shqipe u zgjerua nga 10 minuta në 3 orë e 15 minuta. M. Peza është autor i disa dramave (“Përtej vdekjes”, “Quo vadis Keron” etj), nga të cilat “Nuk martohem me parë” ishte njëri nga realizimet më të suksesshme skenike në Teatrin Popullor Krahinor të Prishtinës. Është dhe autor romanesh, novelash, satirash e humoreskash. Për skenarin e filmit “Uka i Bjeshkëve të Nemuna” mori shpërblimin “Dreri i artë” në Festivalin e Filmit Jugosllav në Pula. Është fitues i çmimit më të lartë për gazetarë në Maqedoni “Kërste Misirkov”. (Fatmir Sulejmani)

PËRFAQËSITË E HUAJA DIPLOMATIKE NË KOSOVË. Janë ambasadat dhe zyrat e tjera diplomatike të shteteve të huaja dhe të organizatave ndërkombëtare, të cilat veprojnë në Kosovë. Në nivel të ambasadave në Kosovë përfaqësohen: Austria, Bullgaria, Çekia, Finlanda, Gjermania, Franca, Holanda, Italia, Kroacia, Luksemburgu, Mali i Zi, Maqedonia, Mbretëria e Bashkuar, Norvegjia, SHBA-ja, Shqipëria, Sllovenia, Suedia, Turqia dhe Zvicra. Ndërkaq një numër shtetesh të tjera përfaqësohen me ambasadorë jorezidentë. Belgjika përfaqësohet në Kosovë me zyrë diplomatike; Japonia, Greqia, Sllovakia dhe Rumania përfaqësohen me zyrë ndërlidhëse, ndërsa prani diplomatike në nivel të zyrës kanë Kina dhe Rusia. Organizata të shumta ndërkombëtare po ashtu janë të përfaqësuara në Kosovë, përfshirë Bashkimin Europian, Këshillin e Europës, OSBE-në, agjencitë e Kombeve të Bashkuara, FMN-në, Banka Botërore etj. (Ilir Dugolli)

PËRFAQËSUESIT SPECIALË TË OKB-SË NË KOSOVË (1999-2012). Autoriteti më i lartë në Kosovë në periudhën e administrimit të përkohshëm ndërkombëtar, bazuar në Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1244/99. Në periudhën 1999-2008, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) të OKB-së udhëhiqte me misionin e OKB-së në Kosovë (UNMIK-un) dhe kishte pushtetin

e plotë legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor, si dhe përfaqësonte vendin në marrëdhëniet ndërkombëtare. Ndërkaq, pas pavarësimit të Kosovës (2008-2012), PSSP-ja kishte funksion më tepër këshillëdhënës. Me mandat të plotfuqishëm ekzekutiv ishin gjashtë PSSP-të e parë të OKB-së: Sergio de Melo, Bernard Kushner, Hans Hakerup, Hari Holker, Mihael Shtainer dhe Soren Jesen Petersen, ndërkaq Lamberto Zanieri dhe Farid Zarif i përkisnin kategorisë së dytë. Profili politik i PSSP-së ishte i ndryshëm, nga ish-presidentë dhe ish-ministra në vendet e tyre, deri te zyrtarë të lartë të OKB-së, apo diplomatë të karrierës. PSSP-ja vazhdon t’ia paraqesë raportet vjetore Këshillit të Sigurimit të OKB-së për funksionimin e UNMIK-ut dhe për gjendjen politike dhe të sigurisë në Kosovë. (Blerim Reka)

PËRGATITJA PROFESIONALE E MËSIMDHËNËSVE. Arsimimi dhe aftësimi profesional për mësimdhënie. Format e para të arsimimit profesional të mësuesve shqiptarë ishin seminarët dhe shkollat normale. Shkolla e parë normale (shqiptare-rumune) ishte ajo e Bukureshtit (1892), pastaj Normalja e Elbasanit (1909), ku u regjistruan edhe shumë të rinj nga Kosova. Për përgatitjen e mësuesve kosovarë dhanë kontribut edhe shkollat turke, sidomos normalja turke e Shkupit. E para shkollë normale shqipe në Kosovë u themelua në Prishtinë (1941), për të vazhduar me shkolla të tilla pas Luftës së Dytë Botërore në Gjakovë (1946), në Prizren, në Prishtinë, në Ferizaj etj., me mësim katër, pastaj pesëvjeçar, ku u përgatit kuadri arsimor për shkollën fillore shqipe dhe serbokroate jo vetëm në Kosovë, por edhe në të gjitha trevat shqiptare në ish-jugosllavi. Krahas tyre, u organizuan edhe kurse pedagogjike për kualifikimin e mësuesve të pakualifikuar. Në vitin 1958 u themelua Shkolla e Lartë Pedagogjike e Prishtinës, pas së cilës edhe shkolla të tjera të larta, duke përfshirë edhe akademitë pedagogjike për përgatitjen e mësimdhënësve të institucioneve parashkollore për mësimin klasor dhe lëndor të shkollës fillore tetëvjeçare. Përgatitja profesionale e mësimdhënësve kosovarë të shkollave të mesme filloi në Universitetin e Beogradit, të Shkupit etj. Me themelimin e Fakultetit Filozofik në Prishtinë (1960), si dhe të disa fakulteteve të tjerë pas tij, u krijuan kushtet për përgatitjen profesionale

të mësimdhënësve për shkolla të mesme dhe të larta. Në vitin 1997 themelohet Fakulteti i Mësuesisë në Prishtinë, me të cilin filloi arsimimi universitar i mësuesve të shkollës fillore. Në vitin 2002 ky fakultet u shndërrua në Fakultet të Edukimit, me seli në Prishtinë, me katër qendra rajonale: në Prishtinë, në Gjilan, në Gjakovë dhe në Prizren. Krahas studimeve të rregullta katërvjeçare, Fakultet i Edukimit organizoi edhe aftësimin e mësimdhënësve pa shkëputje nga puna, me synim që të gjithë mësimdhënësit e institucioneve parashkollore, të shkollës fillore dhe të mesme të ulët të kenë kualifikim universitar. Me themelimin e universiteteve të tjera publike në Kosovë, u krijuan kushte në të mirë të kualifikimit universitar të mësuesve kosovarë. Ndihej të rëndësishme në ngritjen profesionale të mësimdhënësve në Kosovë kanë dhënë edhe institucione dhe asociacione ndërkombëtare dhe vendore. (Islam Krasniqi)

PËRHAPJA E ISLAMIT NË KOSOVË. Filloi si proces pas pushtimit osman të kësaj treve më 1455, duke qenë pjesë e procesit të përgjithshëm të islamizimit që u zhvillua në hapësirën shqiptare gjatë periudhës osmane. Faktorë nxitës për islamizimin e popullsisë së Kosovës, ndër të tjera, ishte mungesa e një kishe gjithëshqiptare, dobësitë që shfaqnin institucionet e krishtera në këto territore, rëndesa e taksës së xhizjes (taksë vetëm për popullsitë jomyslimane), detyrimi i devshirmesë (dërgimi i detyruar periodik i djemve të krishterë në Stamboll), prirjet për të përfutur nga avantazhet e sistemit politik dhe ekonomik osman etj. Koha dhe ritmika e këtij procesi në Kosovë lidhen edhe me tipare specifike të realitetit politik dhe fetar të kohës paraosmane. Meqë vendosja e sundimit osman në këtë rajon i dha fund pushtetit politik dhe fetar serb, në shenjë të ndarjes me gjendjen e mëparshme, popullsia shqiptare e këtushme e përqafoi më shpejt fenë islame. Të dhënat që ofrojnë defterët osmanë të regjistrimit të pronave dhe të popullsisë tregojnë se përhapja e Islamit ishte një dukuri karakteristike e panoramës fetare të vendbanimeve të Kosovës duke filluar që nga shek. XV. Ndërsa në regjistrimin e parë osman (viti 1455) në territorin e Kosovës të përfshirë në këtë regjistrim janë shënuar vetëm 10 shtëpi të islamizuara (në nahijen e Tërgovishtës), në dekadat e fundit të shekullit të lartpërmendur,

feja islame kishte depërtuar ndjeshëm në radhët e popullsisë, veçanërisht asaj qytetare. Më 1485 qyteti i Pejës kishte 23 shtëpi myslimane, ndërsa dy vjet më vonë, në qytetin e Vuçitërnës ekzistonte bashkësia myslimane me 33 shtëpi nga 107 shtëpi që kishte gjithsej qyteti. Një pamje të ngjashme për sa i përket përhapjes së Islamit e paraqet edhe Prishtina më 1487. Nga 299 shtëpi të qytetit në fjalë, 51 syresh kishin kaluar në fenë islame.

Gjatë shek. XVI-XVII përhapja e islamit në hapësirën e Kosovës fitoi një dinamikë më të shpejtë dhe masivitet më të gjerë. Popullsia e islamizuar e qyteteve u shtua së tepërmi. Banorët myslimanë të Pejës zinin rreth 90% të numrit të përgjithshëm të popullsisë, ndërkohë që në Vuçitërnë popullsia myslimane kishte arritur në rreth 80%, në Prishtinë e Prizren 60%, etj. Gjatë kësaj periudhe feja islame depërtoi fuqishëm edhe në radhët e popullsisë fshatare. Shumë fshatra u islamizuan tërësisht, ndërkohë që struktura fetare e pjesës tjetër të këtyre vendbanimeve pësoi ndryshime të thella në dobi të islamit. Të dhënat nga burimet osmane dhe nga ato perëndimore tregojnë qartë se deri në vitet '80 të shek. XVII shumica dërrmuese e popullsisë së Kosovës kishte kaluar në islam. Ky fakt hedh poshtë pikëpamjen se "shqiptarizimi" dhe rrjedhimisht islamizimi i Kosovës u realizuan pas vitit 1690, kur ndodhi e ashtuquajtura "shpërngulje e madhe serbe" nga këto treva.

Për t'iu shmangur islamizimit, individë ose grupe të caktuara nga popullsia e krishterë kosovare, veçanërisht ajo katolike, zgjodhën të praktikojnë krishterimin e fshehtë (kriptokristianizmin), dukuri që vijoi deri në shek. XIX dhe përfundoi ose me kalimin e tyre përfundimtar në islam, ose me rikthimin në fenë e krishterë. (Ferit Duka)

PËRKRENARJA ILIRE. Pajisje ushtarake mbrojtëse ilire. U krijua në gjysmën e dytë të shek. VII mbi modifikimin e modelit të përkrenares korintike. Dallohet nga kalota sferike, me lugun për vendosjen e pubzës, hapjen katërkëndëshe për fytyrën dhe prerjen e thellë trekëndëshe midis llapave të faqeve dhe mbrojtjes së qafës. Duket për herë të parë në varrezën e Borovës (Kolonjë) dhe dallohet për formën cilindrike me kalotë të ulët. Pjesa më e madhe e ekzemplarëve i takojnë shek. VI-IV, kur ka përhapje të gjerë në trevat ilire

të Bosnjës, luginës së Matit, zonës së Dumresë, por edhe në Epir (nekropoli i Janinës) dhe në Thesali (nekrololet e Sindos dhe Karaburun te Selaniku). Në Dardani e rreth saj janë gjetur përkrenare të kësaj periudhe në varret princore të Banjës së Pejës, Novi Pazarit, Atenicës te Çaçaku, Terbenishtit te Ohri, si dhe dy përkrenaret e Korishës dhe një e Dejës. Përkrenarja ilire u përdor dhe në shek. III-II, duke u karakterizuar me rumbullakim të hapësirave midis llapave të faqes dhe mbrojtjes së qafës. Ky tip paraqitet në përkrenaren e Lezhës, monedhat prej bronzi të Skodrës e Lisit, kalorësi dhe dy këmbësorët ilirë me pafta prej argjendi nga Selca e Poshtme (Pogradec) dhe monumenti mortar i Kamenicës në Kosovë. (Neritan Ceka)

PËRKTHIMI LETRAR NË KOSOVË. Është përvoja e fituar në Kosovë e rikrijimit të një tekste letrar nga gjuha në të cilën është shkruar, në gjuhën shqipe, ose nga shqipja në një gjuhë tjetër. Tradita e përkthimit nga gjuhë të tjetra në gjuhën shqipe është e vjetër, aq sa janë librat dhe dokumentet e para të shkrimit shqip. Një pjesë e teksteve të letërsisë së vjetër shqipe janë adaptime tekstesh sakrale për nevoja të besimtarëve. Autorët e shek. XVI, XVII, XVIII, (Buzuku, Budi, Bogdani, deri te Kazazi) vinin nga veriu i tokave shqiptare dhe kishin shtrirje apo kishin shërbyer edhe në Kosovë, ose ishin vetë nga këto anë, ndaj dhe tradita e përkthimit në Kosovë duket më e thellë se ç'mendohej. Përkthimi sakral ka vazhduar më vonë në teqe e xhami, në qerthuj të klerit mysliman. Përkthime të mirëfillta letrare në kohën e Perandorisë Osmane, por dhe në të mbretërisë jugosllave në Kosovë janë të rralla. Ato gjejnë një nismë të re pas Luftës së Dytë Botërore, kur përkthehej nga gjuhët e “kombeve dhe kombësive” (kryesisht nga serbishtja) në gjuhën shqipe dhe më rrallë në anë të kundërt. Vetëm Shtëpia botuese “Rilindja” kishte përkthyer mbi 200 tituj të autorëve të ish-Jugosllavisë. Krahas kësaj kjo plejadë përkthyesish (E. Mekuli, T. Hatipi, V. Shita, R. Kelmendi, M. Ramadani e shumë të tjerë) përkthenin dhe autorë botërore, kryesisht nga gjuha serbokroate. Kështu, E. Mekuli, përveç shkrimtarëve jugosllavë, përktheu në shqip edhe Beketin, Londonin, Jeseninin, Pushkinin; V. Shita përktheu Niçen, ndërsa R. Kelmendi shqipëroi Markesin etj. Letërsia botërore në Kosovë vinte dhe nga

emra të njohur përkthyesish, si Noli, Luarasi, Pasko, Papakristo, Kokona, Zheji, Caci, Gjeçi, Shvarc etj. të cilët i ribotonte “Rilindja” në vitet ‘70-‘80. Në këtë periudhë u shfaqën edhe përkthyes nga Kosova, të cilët i përkthenin veprat nga origjinali (M. Hoxha, G. Luboteni, Z. Rexha, A. Çetta, Y. Jaka, M. Raifi, M. Stavileci, A. Karjagdiu, R. Ismajli, E. Basha, M. Kërveshi, M. Saneja etj.). Në kohën e barrierave ideologjike në letërsinë shqipe, një pjesë e këtyre përkthyesve sillnin në shqip autorë që në Shqipëri konsideroheshin dekadentë (Prust, Kamy, Sartër, Dostojevski, Jonesko, Bodler, Rembo, Prever, Beket etj.), ose Biblën (Dom Simon Filipaj nga Ulqini). Një kohë në Kosovë ka vepruar Shoqata e Përkthyesve Letrarë, e cila koordinonte punën dhe u dilte në ndihmë përkthyesve letrarë. Shoqata merrej edhe me çështje teorike të përkthimit letrar. Ajo ushtronte dhe veprimtari botuese, duke paraqitur në gjuhë të huaja tekste të zgjedhura të letërsisë shqipe. Për përkthimin nga shqipja në gjuhë të huaja janë angazhuar përkthyes të jashtëm e vendorë (Elsi, Hoxhson, Zoto, Monteko, Gyt, Lanksh, Rohm, Saneja, Ymeri etj.) Të gjithë këta kanë përkthyer dhe botuar në gjuhë të huaja vepra të ndryshme letrare, ndaj mund të thuhet se në sajë të tyre shumë autorë nga Kosova janë të pranishëm me libra të veçantë apo me poezi, prozë dhe ese në faqet e revistave të specializuara letrare të Europës dhe më gjerë. (Eqrem Basha)

PËRLEPNICA. Fshat në komunën e Gjilanit në rajonin e Anamoravës, shtrihet në pjesën lindore të komunës, rreth 7 km larg nga qyteti, në lartësi mesatare mbidetare 715 m. Është vendbanim i tipit të dendur. Mbi fshat është ndërtuar akumulacioni ujqor, nga i cili shfrytëzohet uji për pije dhe bujqësi. Gjatë periudhës 1948-2011 popullsia e fshatit shënon rritje të vazhdueshme, që solli deri te transformimi hapësinor dhe morfologjik i tij. Derisa në vitin 1948 në fshat kanë jetuar 1,265 banorë, sipas regjistrimit të fundit (2011) këtu jetojnë 1,944 banorë. Veprimtari kryesore ekonomike janë bujqësia, pemëtaria dhe shërbimet hoteliere. Është qendër e bashkësisë lokale, në të cilën gravitojnë fshatrat Kmetovc dhe Vërbicë e Kmetovcit. Nga objektet e standardit shoqëror fshati ka shkollën 9-vjeçare, stacionin shëndetësor, postën, disa njësi tregtare etj. (Nexhat H. Rexha)

PËRLLESHI Ndue (1908-1949). Luftëtar për çlirim kombëtar të Kosovës, veprimtar i Lëvizjes Nacional-Demokratike Shqiptare. Lindi në Paskalicë të Klinës. Në vitin 1941 u emërua kryetar i komunës në Vogovë të Hasit. Më vonë u emërua kryetar në komunën e Becit të Gjakovës. Deri në fund të vitit 1944 ishte kryetar në komunën e Budisalcit të Klinës. Me fitoren e forcave komuniste u arratis në mal dhe formoi një çetë luftëtarësh, e cila u rrit shumë shpejt. Bashkëpunoi me Shaban Polluzhën dhe u zgjodh anëtar i shtabit të forcave të tij. Pas shuarjes së rezistencës në Drenicë vazhdoi të bashkëpunonte me Ukë Sadikun, Ymer Berishën, Marije Shllakun etj. Në Kuvendin e Dobërdolit u zgjodh udhëheqës ushtarak për rrethin e Pejës. Nënshkroi raportin që iu dërgua gjeneralit anglez Hadsonit më 22 tetor 1945, për situatën politike në Kosovë. Në shkurt të vitit 1948 plagoset në një pritë të OZN-ës. Pas shërimit, largohet në Shqipëri, ku bashkohet me çetën e Ndoc Mirakës në viset e Pukës. U vra nga forcat ushtarake të Shqipërisë në bjeshkët e Iballës, në tentativë për t'u larguar për në Greqi. (Lush Culaj)

PËRMBYTJET UJORE (VËRSHIMET). Është fenomeni i daljes së ujit të lumenjve nga shtretërit e tyre. Territori i Kosovës është i rrezikuar nga ujërat e shumta të lumenjve, nga reshjet e shiut dhe shkrirja e borës gjatë muajve të hershëm të pranverës. Njëkohësisht, nga reshjet e shumta rrjedhin sasi të mëdha të ujërave nga pjesët e larta (maleve), duke bartur edhe materiale të shkrifëta (lym, argjilë, rërë etj.). Vërshimet më të mëdha në Kosovë ndodhin në pjesët e poshtme të Drinit të Bardhë, të Bisticës së Prizrenit dhe të Pejës, të Sitnicës, të Llapit, të Drenicës dhe të Moravës së Binçës. Nga dalja e ujit nga shtretërit e lumenjve çdo vit përmythen mbi 10,000 ha tokë. Vërshime lokale, me përfshirje të sipërfaqeve më të vogla dhe me kohëzgjatje më të shkurtër, ndodhin nga të gjithë lumenjtë e Kosovës, gjatë muajve të hershëm të pranverës, por edhe gjatë muajve tetor-nëntor. Vërshimet më të mëdha të ndodhura deri më tani janë ato të vitit 1979, të shkaktuara nga reshjet enorme, me çrast për 5 ditë (16-20 nëntor) ranë rreth 300 mm dhe shkaktuan përmytje që sollën dëme të mëdha, të vlerësuara me 26.4% të të ardhurave të përgjithshme nacionale (sipas të ardhurave nacionale të vitit 1978). Gjithashtu,

në periudhën 15-19 prill 2014, për shkak të reshjeve të shumta (150 mm), gati të gjithë lumenjtë e Kosovës dolën nga shtretërit, duke shkaktuar vërshime të konsiderueshme. Ndërtimi i 6 digave dhe akumulimi i ujërave vjetore të lumenjve përkatës kanë ndikuar dukshëm në zvogëlimin e përmytjeve. Për evitim të përmytjeve dhe të proceseve erozive është e domosdoshme rregullimi i shtretërve të lumenjve, ndërtimi i digave për akumulimin e ujërave vjetore, ruajtja e pyjeve dhe pyllëzimi i sipërfaqeve të zhveshura. (Bashkim Kabashi)

PËRZHITA Luan (1956-). Arkeolog, profesor universiteti. Lindi në Kukës. Kreu studimet në Fakultetin e Historisë dhe Gjeografisë në Universitetin "Luigj Gurakuqi" (Shkodër) dhe nga viti 1982 punoi në fushën e antikitetit të vonë dhe mesjetës në Institutin e Arkeologjisë në Tiranë. Mbrojti tezën e doktoratës më 1992 dhe fitoi titullin "Mjeshtër kërkimesh" (2000). Është përqendruar në ndryshimet urbane dhe rurale, procesin e kristianizimit të hershëm dhe fortifikimet e antikitetit të vonë në provincat Dardania dhe Epiri i Vjetër. Drejtoi gërmime arkeologjike në Shqipërinë Verilindore, Kosovë, Maqedoni, rrugën antike Lissus-Naissus etj. Është autor dhe bashkautor i botimeve monografike "Qyteza dardane në Kodrën e Pecës", "Fortifikime të shekujve IV-VI në Dardanië Perëndimore", "Monumente historike të kultit kristian në Dioqezën e Lezhës", "Harta arkeologjike e Kosovës" etj. Botoi mbi një sërë artikujsh në revista shkencore në Shqipëri dhe jashtë, si dhe studime popullore të tekste shkollorë. Ligjëroi në Universitetin e Tiranës, në Lion 2, në Sorbonë (Paris IV) dhe në Shkollën Doktorale të Arkeologjisë (QSA), pastaj ishte drejtor i Institutit të Arkeologjisë dhe kryeredaktor i revistës "Iliria". (Gëzim Hoxha)

PËRRALLA. Krijim folklorik në prozë me përmbajtje të trilluar. Elementi mbinatyror përfaqëson substancën, ligjshmëritë dhe frymën e saj, ndërsa e mrekullishmja është element i veprimit, shprehje e stilit abstrakt, e ideve dhe e modeleve të saj. Veçori e përrallës është papërcaktueshmëria e vendit, e kohës dhe mungesa e vërtetësisë. Përralla përmban elemente të jetës së përditshme, motive me prejardhje magjike dhe mitologjike, relikte të ritualeve dhe të zakoneve, motive seksuale dhe simbole, të cilat lirohen nga

kuptimi konkret dhe marrin nuanca artistike. Struktura rrëfimore e përrallës fillon me formulën hyrëse “Na ishte një herë”, ose “Ish kanë një mbret” etj., dhe përfundon me formulën përmbyllëse: “Ata u martuan dhe jetuan të lumtur” ose “Bënë dasmën dhe jetuan të lumtur” ose “Përralla në shkallë dukati në ballë”. Zhvillimi i ndodhisë e çon kryepersonazhin në përballje me sprova dhe pengesa të shumta, tejkalimi i të cilave shpie në përfundim të lumtur, më së shpeshti me martesën e heroit ose të heroinës, që nënkupton fillimin e një jete të lumtur. Personazhe të përrallës janë njerëzit e rëndomtë, por edhe njerëz me veti mitike, pastaj kafshët dhe qeniet e ndryshme mitike. Marrëdhëniet në përrallë ndërtohen sipas sistemit semiotik të opozitave i mirë-i keq; i veti i huaji; kjo botë-ajo botë; lart-poshtë etj. Përrallat shqiptare janë botuar fillimisht nga mbledhësit e huaj të folklorit, si: J. G. V. Hahn, A. Dozon, J. U. Jarnik, H. Pedersen, G. Majer, M. Lamberg etj., si dhe nga mbledhësit dhe studiuesit e periudhës së Rilindjes Kombëtare. Botimi sistematik i përrallave fillon me “Visaret e Kombit” dhe me vëllimet e D. Kurtit. Në gjysmën e dytë të shek. XX në Tiranë dhe në Prishtinë botohen një sërë vëllimesh me këtë lloj të krijimtarisë popullore. (Myzafer Mustafa)

PËRRALLËZAT. Rrëfime të shkurtra folklorike në prozë dhe në vargje. Personazhet kryesore në to janë kafshët, shpendët, zvarranikët, brejtësit, insektet, trupat qiellorë, dukuritë natyrore, bimët, pemët, perimet dhe gjësendet. Përmes këtyre personazheve paraqiten në mënyrë alegorike marrëdhëniet njerëzore, duke i përqeshur dobësitë ose duke i lavdëruar virtytet. Përrallëza është shumë e përafërt me anekdotën popullore. Mesazhi i saj është kryesisht didaktik-moralizues, që shprehet dendur me anë të rrëfimit alegorik. Në fushën e folkloristikës mbizotëron emërtimi fabul. Studiuesit mendojnë se përrallëzat kanë prejardhje nga India dhe me kohë janë përhapur në mbarë Europën dhe më gjerë. Fabulisti më i njohur është Ezopi i kohës antike helene, që përrallëzën e pasuroi me përmbajtje dhe vlera artistike. Në letërsinë shqipe përrallëzat i kanë shkruar ose përshtatur me sukses rilindësit tanë, si: N. Frashëri, Çajupi, A. Santori, A. Xanoni, N. Mjeda etj. Në Institutin Alabanologjik të Prishtinës është bërë një botim më vete i përrallëzave (“Fabula”, 2008). (Adem Zejnullahu)

PIKOLOMINI Ene Silvi Pio II (Aeneas Sylvius Piccolomini) (1405-1464). Papë, humanist, poet, diplomat. Lindi në Corsignano të Sienës në Itali. Në vitin 1442 u emërua sekretar në kancelarinë e perandorit Frederiku III. Pas një jete të gjatë civile, i edukuar në Universitetin e Sienës dhe të Firences, iu kthye jetës kishtarë. Në vitin 1447 papa Nikolla V e emëroi ipeshkëv të Trieshtës, ndërsa në vitin 1450 ipeshkëv të Sienës. Në vitin 1458 u zgjodh papë dhe mori emrin Pius II. U shqua në luftë kundër depërtimeve osmane. Thirri kongresin e krerëve të krishterë në Mantova (1459-1460) për veprim të përbashkët kundër osmanëve. Për pikëpamjen e tij Skënderbeu ishte njëri ndër protagonistët kryesorë të kësaj lufte. Vdiq papritmas, në udhëtim e sipër, në Ankona. Ka lënë të shkruara një sërë veprash, ndër të cilat: “Përshkrimi i shkëlqyeshëm i Azisë dhe Europës” (1534), “Komente të veprave që vlejné të përmenden...” (1584) etj. Në këto vepra gjenden njoftime të shumta për Arbërinë dhe Skënderbeun. Në “Komentet” Piu II flet në mënyrë lavdëruese për Skënderbeun, si dhe për ekspeditën e tij në Itali, për letërkëmbimet ndërmjet Skënderbeut dhe princit të Tarentit, për armëpushimin midis Skënderbeut dhe Mehmetit II në vitin 1460, për ndihmat financiare që i janë akorduar Skënderbeut nga papati etj. Në veprën “Përshkrimi i shkëlqyeshëm i Azisë dhe Europës” gjendet një pjesë shumë e rëndësishme për babanë e Skënderbeut, sipas të cilit Gjon Kastrioti ishte konvertuar në mysliman dhe kishte marrë emrin Kamusa, që sipas Nolit është një shtrembërim i emrit Hamza. Po në këtë vepër gjenden edhe të dhëna të ndryshme mbi vitet e fëmijërisë së Skënderbeut. (Gjon Berisha)

PIKOLOMINI Enea Silvio (1640-1689). Gjeneral i njohur i ushtrisë austriake në kohën e luftërave austro-osmane (1683-1699). Pasi tregoi sukses për ta bindur një pjesë të banorëve vendës që t'i bashkoheshin ushtrisë austriake, ai u caktua ta drejtonte fushatën kundër osmanëve në Kosovë, Serbi, Bosnjë dhe Maqedoni. Synimi i Pikolominit ishte që nëpërmjet Prokuplës dhe Shqipërisë së Sipërme të dilte në Adriatik, në mënyrë që ta shkëpuste Bosnjën nga Perandoria Osmane. Vetëm në Prishtinë rreth 5,000 shqiptarë iu bashkuan vullnetarisht ushtrisë së Pikolominit. Më 25 tetor 1689, Pikolomini me ushtrinë e tij austriake dhe repartet vullnetare u

nis nga Kaçaniku drejt Shkupit, ku iu bashkuan edhe kryengritësit e Karposhit. Shkupi ra në duart e Pikolominit pa vështirësi, pasi këtë qytet e kishte pllakosur epidemia e murtajës. Por ai nuk desh ta rrezikonte ushtrinë e vet nga murtaja dhe më 26 tetor 1689 urdhëroi që ky qytet të digjej. Pastaj e vazhdoi fushatën drejt Prishtinës dhe Klinës, ku iu bashkuan rreth 6,000 vullnetarë shqiptarë, me një numër të madh qerresh dhe kafshësh. Kur dëgjoji se ushtria osmane e kishte lënë fortifikatën e Kaçanikut dhe ishte pozicionuar në fushë të hapur, Pikolomini iu drejtua pozitave të ushtrisë osmane, e cila pasi iku për t'u strehuar në pyll, pësoi disfatë të thellë nga repartet kalorësiake të gjeeralit austriak. Pas këtij suksesi, Pikolomini shkoi në Kaçanik, ku popullsia e entuziazmuar iu bashkua në masë. Pikolomini, ndonëse i sëmurë nga murtaja, vazhdoi rrugën për në Lipjan, e pastaj në Drenicë, ku e kuptoi se ushtria osmane ishte ripozicionuar duke e rrethuar ushtrinë e tij. Pikolomini këtë herë pësoi disfatë dhe në tërheqje e sipër urdhëroi që një pjesë e ushtrisë së tij të tërhiqej në Nish, ndërkaq vetë vazhdoi për në Prizren. Aty u prit nga argjipeshkvi i Shqipërisë, Pjetër Bogdani dhe Toma Raspasani, të shoqëruar nga 8 mijë vullnetarë shqiptarë. Nga këta vullnetarë Pikolomini e formoi "Milicinë shqiptare", ashtu që ushtria austriake u rrit në rreth 20 mijë ushtarë. Mirëpo sëmundja e Pikolominit mori hov shpejt dhe më 9 nëntor 1689 ai vdiq në Prizren. Trashëgimtari i Pikolominit, duka Gjergj Kristiani dështoi plotësisht dhe ushtria austriake u detyrua të tërhiqej në veri. (Gazmend Rizaj)

PIKTURA. Si fushë e arteve pamore, piktura në Kosovë daton nga periudhat e hershme duke filluar nga arti ilir, arti mesjetar e deri në paraqitjen e tendencave të para të artit modern. Pra, në aspektin zhvillimor, ajo vazhdon traditën, duke spikatur motivet dhe imazhet e ambientit kosovar nga artizanalet, dekorimet, pikturat murale e deri te drejtimet moderne të artit bashkëkohor. Piktoret e grupit të parë, të cilët do ta fillojnë një kapitull të ri, të një fryme moderne, që tërësisht do të ndahet nga arti dhe piktura aplikative apo dekorative dhe do t'i hapë shtigjet e reja të artit tradicional, duke filluar nga realizmi, intimizmi, impresionizmi e deri te rrymat më moderne të viteve tridhjetë, do të jenë piktoret: Abdurrahim Buza, Qamil



HAPJA E NJË EKSPOZITE NË ASHAK

Greza dhe Shahin Kryeziu. Motivet karakteristike të piktorit Abdurrahim Buza me imazhe nga Gjakova dhe paralagjet e qyteteve të tjera kosovare padyshim që do të lënë gjurmë në brezat e mëvonshëm të piktorëve. "Dasma gjakovare", "Vajza me kordele" "Peizazhet" do bëhen sinonim për shumë piktorë të brezave të ardhshëm. Megjithatë, datë e rëndësishme për zhvillimin e pikturës në Kosovë është hapja e Shkollës së Mesme të Arteve në Pejë më 1949. Nga kjo shkollë nismëtarët e parë të pikturës do t'i marrin njohuritë e para për artin figurativ dhe aplikativ. Do të marrin dije mbi elementet e kompozimit, duke filluar nga linja, ngjyra, forma, raportet kontrastive, dritë-hija e deri të formësimi piktural. Zhvillimi më i madh i pikturës në Kosovë padyshim do vijë pas hapjes së Akademisë së Arteve në Prishtinë më 1973, prej nga dolën shumë breza piktorësh. Pra, piktura si fushë e arteve pamore do të jetë themeli i zhvillimit të mëtejshëm drejt përparimit në rrjedhat zhvillimore të arteve në përgjithësi. Karakteristikat e përgjithshme të zhvillimit të kulturës dhe artit në Kosovë gjatë periudhës pas Luftës së Dytë Botërore flasin për një rrugë të vështirë dhe për përpjekjet e vazhdueshme për një shkallë sa më të lartë zhvillimi. Por, me paraqitjen e brezit të parë të piktorëve si: Muslim Mulliqi, Tahir Emra, Rexhep Ferri, Xhevdet Xhafa, Gjellosh Gjokaj, Nysret Salihamixhiqi, Engjëll Berisha, Kadrush Rama e shumë të tjerë, gradualisht filloi një frymë më ndryshe në skenën artistike. Filluan të organizohen ekspozitat personale si ajo e Shahin Kryeziut dhe e Muslim Mulliqit në vitin 1953 në Gjakovë, që padyshim ishin ngjarje kulturore që do të ndikojnë edhe te piktorët e tjerë, si dhe ato kolektive, që do të kulmojnë

me evenimentet më të njohura tradicionale siç janë: Salloni Pranveror, Salloni Vjeshtor, Bienalja e Vizatimit dhe ekspozitat tradicionale rajonale të Shoqatave të Artistëve Figurativë e Aplikativë të Kosovës. Piktura në të gjitha këto manifestime ishte dominuese si për nga vlerat estetike-artistike, ashtu edhe për nga numri impozant i krijuesve. Nga vitet '70 dhe deri në vitet '90 të shekullit të kaluar, piktura e Kosovës gjithnjë e më shpesh u shfaq në qendra të ndryshme si brenda vendit, ashtu edhe në vendet e rajonit dhe më gjerë në Europë. Piktoret filluan të depërtojnë edhe në qendrat e njohura europiane, ku disa prej tyre do të qëndrojnë për një kohë më të shkurtër, ndërsa disa të tjerë, si Gjelosh Gjokaj, Daut Berisha, Mikel Gjokaj, Bahri Drançolli, Abdylkader Pagarusha, Valdet Kuçi, Shyqri Gjurkaj etj., mbeten dhe sot të veprojne aktivisht në këto qendra. Kundrejt drejtimeve më të hershme tradicionale si: realizmi, intimizmi, ekspresionizmi, pas viteve tetëdhjetë do reflektojnë drejtimet e reja, deri tek instalacionet, videoarti dhe lëvizjet e tjera alternative të viteve nëntëdhjetë e më vonë. (Hivzi Muharremi)

PINGPONGU. Fillimet e para i pati në vitin 1945, kur edhe u mbajtën garat e para në Kosovë ndërmjet Mitrovicës, Pejës dhe Prizrenit. Më 27 nëntor të vitit 1952 në Prishtinë u mbajt mbledhja themeluese e Lidhjes së Pingpongut të Kosovës. Garat e para ekipore u organizuan në Prishtinë më 11 dhjetor të vitit 1952. Federata e Pingpongut e Kosovës në vitin 1991 i rifilloi garat e pavarura në të cilat u paraqitën 9 skuadra: "7 Shtatori", "Prishtina", "Dardania" dhe "4 Llullat" (Prishtinë), "Hasan Prishtina" (Vushtrri), "Besiana" (Podujevë), "Vëllaznimi" (Gjakovë), "Kosovari" (Bardh i Madh) dhe "Drita" (Gjilan). Federata është pranuar në Federatën Ndërkombëtare të Tenisit (ITTF) që nga vitit 2003 dhe merr pjesë në të gjitha garat ndërkombëtare, me klube dhe me përfaqësuese. (Besim Kajtazi)

PIPERKU Musa (1945-2005). Kompozitor, mësimdhënës. Lindi në Dibër. Kreu Shkollën e Mesme të Muzikës në Prizren, Akademinë e Muzikës, drejtimin teorik-pedagogjik, në Beograd. Pas studimeve, për tri vjet ishte në vendlindje mësimdhënës i muzikës në shkollën fillore dhe në gjimnaz. Atje formoi orkestrën e mandolinave dhe korin e gjimnazit. Njëkohë-



MUSA PIPERKU

sisht drejtoi dhe Shoqëri-në kulturore-artistike "Liman Kaba" si dhe orkestrën popullore me solistët. Kompozoi këngë për fëmijë, që u botuan në revistat "Gëzimi", "Pionieri", "Flaka" dhe 6 këngë për përmbledhjen e këngëve të shkronjave të alfabetit shqip, bashkë kompozitorë të tjerë mbi tekste të poetit Mehmedali Hoxha. Në vitet 1971-1972 ishte bashkëpunëtor, producent, redaktor muzike në Radio-Shkup dhe udhëhoqi korin e Shkollës tetëvjeçare "Liria". Në Shkollën e Lartë Pedagogjike të Shkupit ligjëroi metodikën e muzikës. Më 1973 kaloi në redaksinë e muzikës së lehtë të Radio-Prishtinës, ku qëndroi deri në dëbimin nga puna (1990). Punoi në librin "Tingujt gazmorë" për kl. VI (bashkautor Gj. Smokvarski) për shkollat fillore në Maqedoni. Për disa vjet dha historinë e muzikës në Shkollën e Mesme të Muzikës në Prishtinë dhe ishte udhëheqës i SHKA të studentëve "R. Sadiku" të Universitetit të Prishtinës. M Piperku krijoi këngë që i kënduan N. Pagarusha, L. Çavolli, ("Floriana"), Sh. Gashi, Q. Dushku, B. Paçuku ("Barinjte e Korabit"), S. Fejzullahu ("Pranvera në Prishtinë"), B. Krajkju ("Këngë moj"), kompozoi këngë për duetin Çavolli-Pagarusha. Bashkëpunoi me poetët E. Basha, M. Berisha. G. Misini etj. La mbi 600 këngë zhanresh të ndryshme, muzikën e serialit "Fidani" etj. U shpërblye nga juritë dhe publiku me 7 "Okarina të arta" dhe me një sërë çmimesh të tjera nga Shoqata e Kompozitorëve e Kosovës dhe e Jugosllavisë. Mori pjesë në Festivalin e Gjakovës, në "Zambaku i Prizrenit", në atë të Tetovës, Shkupit, Shkodrës, Opatisë, Ilixhës-Sarajevës, në zgjedhjen e "Këngës së Evropizionit" etj. (Arnisa Rexhepi)

PIRA Islam (1866-1931). Veprihtar i Lëvizjes Kombëtare. Lindi në fshatin Pozharan. Ishte njëri ndër bashkëluftëtarët më të ngushtë të Idriz Seferit. Mori pjesë në lëvizjen xhonturke dhe në ngjarjet që u lidhën me Kuvendin e Ferizajt të vitit 1908. Kontribuoi në hapjen e shkollës shqipe në Pozhoran në vitin 1909. Ndonëse ishte kryetar i komunës së Pozhoranit, pengoi shpërnguljet e shqiptarëve për në Turqi dhe ndihmoi rezistencën e lëvizjes kaçake në viset e Gjilanit dhe të rrethinës. Ishte ndër

prijësit kryesorë të kryengritësve të Moravës dhe të Karadakut në vitet 1910-1912. Luftoi kundër pushtimit serb të Kosovës në tetor të vitit 1912. Për shkak të ndjekjeve, gjatë viteve 1912-1915 qëndroi në Shqipëri. Pas kthimit në vendlindje në vitin 1915, luftoi kundër pushtimit bullgar në trevat e Moravës dhe Karadakut. Me akuzën për lidhje me kaçakët dhe për veprimtari kundër shtetit, u burgos më 1929. Vdiq disa muaj pas liritimit nga burgu nga pasojat e torturave. (Fitim Rifati)

PIRA Zana (1961-). Poete. Lindi në Pozharan të Vitisë. Kreu Shkollën fillore në vendlindje, të mesmen në Gjilan dhe Prishtinë. Studioi në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Gjilan. Me shkrime filloi të merret qysh kur ishte nxënëse. Shkruan poezi për të rritur dhe prozë poetike, për të cilat u shpërblye në manifestime letrare dhe në konkurse të ndryshme. Ka botuar këta libra me poezi: “Hija e Hamletit”, (1994), “Kulla e Ofelisë” (1996), “Mjegull e purpurt” (1997), “Ditëlindja e zjarrit” (1998), “Planeti i mollës” (2001), “Simfonia e syrit” (2001) “Vallja e shiut” (2008), “Valsi i flakërimës” (2010). Merret edhe me publicistikë. (Nazmi Rrahmani)

PIRAJ Sami (1956-). Gazetar, kompozitor. Lindi në Pozhoran të Vitisë. Kreu Shkollën e Mesme të Muzikës në Prishtinë dhe më pas u diplomua në Akademinë e Arteve, dega e muzikës, në drejtimin teorik-pedagogjik. Një vit punoi në Shkollën e Ulët të Muzikës në Gjilan, më pas filloi punën në gazetën “Rilindja”, ku ndoqi jetën muzikore në Kosovë. Më 1996 mori çmimin “Gazetari i vitit”. Më pas për 4 vjet bashkëpunoi me gazetën “Bota sot”. Shkroi komente, artikuj, recensione për muzikën, gjithnjë duke e favorizuar artin e mirëfilltë. Kompozoi mbi 200 këngë që u realizuan në festivalet kombëtare. Ka marrë çmime në “Akordet e Kosovës”, “Zambaku i Prizrenit”, “Kosovarja këndon”, “Kënga shqiptare”, “Kënga e jonë”, pastaj në Festivalin e Gjakovës, në “Nota Fest”, “Polifest”, në Festivali i këngës për fëmijë, Shkodër, Ulqin etj. Këngët e tij i interpretuan këngëtarët e njohur të Kosovës e Shqipërisë. Shumë sosh u botuan në kasete e CD të këngëtarëve dhe të festivaleve. Nga 2002 është zyrtar i arteve skenike-muzikore në Ministrinë e Kulturës. Në periudhën 2008-2011 ishte drejtor i departamentit të kulturës po në këtë ministri. (Arnisa Rexhepi)

PIREVA Adil (1945-). Veprimtar i lëvizjes çlirimtare, i burgosur politik. Lindi në Lupç të Poshtëm të Podujevës. Shkollën fillore e kreu në Bardhosh, Shkollën Normale në Prishtinë (1964). Anëtarësohet në Lëvizjen Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve, themeluar nga Adem Demaç. Në vitet 1964-1968 punoi si mësues në vendlindje, më pas fillon punë në “Rilindje” si gazetar. Ishte njëri nga organizatorët e demonstratave të vitit 1968 dhe autor i referatit që u lexua më 27 nëntor në Prishtinë. Disa ditë më vonë burgoset dhe dënohet me 5 vjet burg. Pas vuajtjes së dënimit kreu studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Largohe nga procesi mësimor si i papërshtatshëm dhe punësohet si përkthyes në kombinatin “Agrokosova” në Prishtinë. Në prill të vitit 1981 burgoset sërish dhe vuajti dy muaj izolim. Më 1989 anëtarësohet në Lidhjen Demokratike të Kosovës dhe më 1991 zgjidhet në organet drejtuese të kësaj partie. Më 1993 rikthehet me punë në “Rilindje”, përkatësisht “Bujku”, ku punoi deri në bombardimet e NATO-s. Pas çlirimit të Kosovës punoi si gazetar, redaktues dhe përkthyes në Qendrën për Infomim të Kosovës. Në vitin 2000 u zgjodh anëtar i asamblesë komunale të Prishtinës dhe më vonë anëtar i Këshillit të Komisionit të Pavarur të Medieve. Merret me krijimtari letrare dhe publicistikë. Ka botuar veprat: “Gjashtëdhjeteteta shqiptare” (1994), “Vite shprese dhe qëndrese” (2004), “Sprova shqiptare” (2008), “Poezi për fëmijë” (2008), “Demonstratat e para për Kosovën Republikë” (2016) etj. (Fehmi Rexhepi)

PIREVA Gani (1960-). Gazetar i sportit. Lindi në fshatin Tugjeç të komunës së Kamenicës. Kreu studimet në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës. Me gazetari u angazhua nga viti 2000, fillimisht në Radio “Viktoria” në Gjilan dhe nga viti 2003 në Radio “Dukagjini”. Për shumë vjet ishte kryetar i klubit të pingpongut “Gjilani”, pastaj edhe në klubin e basketbollit “Drita”. Ka vrapsuar nëntë herë në gjysmëmaratonën e Prishtinës. Raporton për Radio-Dukagjinin, kryesisht nga ndeshjet e Superligës së Kosovës në futboll. (Enver Sadiku)

PIREVA Ismail (1942-). Agronom, entomolog, profesor universiteti. Lindi në fshatin Lupç



ISMAIL PIREVA

i Poshtëm, komuna e Podujevës. Shkollën e mesme bujqësore e kreu në Prishtinë, studimet e rregullta në Fakultetin e Bujqësisë të Universitetit të Novi-Sadit (1968), ndërsa studimet pasuniversitare në Fakultetin e Bujqësisë të Universitetit të Zagrebit (1978). Tezën e doktoratës nga lëmi i entomologjisë e mbrojti në po këtë universitet (1990). Punoi në Kombinatin bujqësor industrial “Kosova-Export” si ekspert në mbrojtjen e bimëve dhe udhëheqës i stacionit për mbrojtjen e bimëve. Ligjërues për lëndën entomologjia u zgjodh në Fakultetin e Bujqësisë në vitin 1977, ku pastaj u gradua në të gjithë titujt universitarë. Botoi punime shkencore dhe profesionale. Është bashkautor i disa librave për mbrojtjen e bimëve dhe i teksteve shkollore. Ka qenë prodekan dhe dekan në Fakultetin e Bujqësisë të Universitetit të Prishtinës (1991-1992, 2001). (Latif Susuri)

PIRUSTËT. Fis ilir. Banonin në krahinën e Matit dhe të Mirditës dhe u bënë pjesë e mbretërisë ilire. Njihen në historiografi si fisi më aktiv në luftë kundër romakëve. Sipas autorit antik Livit, mbetën të pavarur edhe pas shkatërrimit të shtetit Ilir në vitin 168 p.e.r. Pirustët morën pjesë në kryengritjen e madhe ilire të viteve 6-9, nën udhëheqjen e Batos së Desidiatëve dhe ishin ndër të fundit që iu nënshtruan pushtimeve romake. Autori antik Straboni, duke folur për rebelimin pirust kundër Cezarit, i sheh dhe si fqinjë me panonianët, të shtyrë shumë në veri. Përmenden për herë të fundit nga Ptolemeu (shek. II), i cili i vendos në lindje të Durrësit. (Emine Kalaja-Hajdari)

PIRRAKU Muhamet (1942-2014). Historian, ish-i burgosur politik. Lindi në fshatin Sankoc të Drenasit. Shkollën fillore e mbaroi në vendlindje dhe në Komoran, ndërsa të mesmen në Prishtinë. Studimet për histori i mbaroi gjithashtu në Prishtinë, ndërsa studimet pasuniversitare i kreu në Universitetin e Zagrebit. Në periudhën 1979-1980 specializoi në fushën e historisë së kulturës në Institutin e Romanistikës-Gjermanistikës në Universitetin e Vjenës. Doktoroi në vitin 1988 në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Një

kohë punoi si mësimdhënës i historisë në Prishtinë dhe arkivist në Arkivin e Kosovës (1967-1971) dhe më pas u zgjodh asistent në Entin e Historisë të Kosovës. Më 1983 filloi punë në Institutin Albanologjik të Prishtinës, në sektorin e historisë. Botoi një sërë punimesh shkencore dhe publicistike, fejtone, kritika e recensione në revista të ndryshme, si dhe mori pjesë në aktivitete shkencore brenda e jashtë Kosovës. Ndër veprat e botuara spikasin: “Kultura kombëtare shqiptare deri në Lidhjen e Prizrenit” (1989), “Salih Gjukë Dukagjini: Shkrolaria e shqipes” (1991), “Ripushtimi jugosllav i Kosovës 1945” (1992), “Mulla Idriz Gjilani dhe Mbrojtja Kombëtare e Kosovës Lindore 1941- 1952” (1995), “Myderriz Ymer Prizreni-Ora, zemra dhe shpirti i Lidhjes Shqiptare 1877-1887” (2003), “Tivari 1945 - Kalvari i Kosovës” (2005) etj. (Fitim Rifati).

PISTHALLO Boshko (Boško Pištalo). (1926-). Regjisor. Kreu studimet për regji teatri në Akademinë për Teatër në Beograd. Në Teatrin Popullor Krahinor, si në Dramën Serbe, ashtu edhe në Dramën Shqipe vendosi në skenë mbi 30 shfaqje teatrore. Prej tyre më të realizuarat mund të konsiderohen: “Ana Kristi”, “Furtuna”, “Pigmalioni”, “Zanat i zonjës Born”, “Natë e pruar”, “Gra të ditura”, “Gruaja e ligë”, “Kurthi i miut”, “Fizikanët” etj. Punoi kryesisht shfaqje që pëlqeshin nga publiku. (Fadil Hysaj)

PIZANI Vitore (Vittore Pisani) (1899-1990). Gjuhëtar italian, indoeuropianist. Lindi në Romë, ku u diplomua për filologji klasike. Ishte profesor në Firencë, pastaj në Milano dhe Kaljari; anëtar korrespondent i Akademisë Kombëtare të Linceit (Romë 1969). Kontribuoi në “Enciklopedinë italiane”, në seksionin e gjuhës. Pisani ka trajtuar aspekte të gjuhëve indoeuropiane, veçanërisht për sanskritishten, greqishten, latinishten dhe gjuhët gjermanike. Në mesin e botimeve të tij veçohen veprat për indishten e vjetër, për gjuhën armene, për greqishten e vjetër, për historinë e latinishtes dhe për gjuhësi të përgjithshme. Themeloi revistën filologjike “Paideia”. Për shqipen botoi: “Shqipja dhe gjuhët e tjera indoeuropiane” (L’albanais et les autres langues indoeuropéennes, Bruksel 1950), “Originat e gjuhës shqipe” (Les origines de la langue albanaise, 1964), “Mbi gjenezën e shqipes” (Sulla genesi dell’albanese, Innsbruck 1972). (Hana Radoniqi)

PLAKOLLI Mujë (1945-). Biolog, profesor universiteti. Lindi në Podujevë, shkollimin bazë e mori në vendlindje, ndërsa studimet i kreu në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore (FSHMN) të Universitetit të Prishtinës. Studimet pasuniversitare i mbaroi në FSHMN të Universitetit të Zagrebit, kurse disertacionin e doktoratës e mbrojti në FSHMN të Universitetit të Prishtinës. Po në këtë fakultet ka punuar ligjërues për lëndët mikrobiologji, ekologji e mikroorganizmave dhe virusologji. Ka publikuar disa punime shkencore dhe profesionale në revista vendore dhe ndërkombëtare, pastaj dispensa dhe një praktikum universitar, tekste për shkollë të mesme dhe një atlas mikrobiologjik. Ka realizuar disa projekte shkencore-hulumtuese. (Behxhet Mustafa)

PLANI "PATKOI". Projekt i koduar serb për dëbimin me forcë të shqiptarëve të Kosovës. Plani u bë i ditur publikisht në prill të vitit 1999, në një konferencë të organizuar në Petersberg të Gjermanisë, e cila asokohe mbante presidencën e radhës të Bashkimit Europian. Në këtë konferencë, ku po merrnin pjesë edhe ministrat e jashtëm të shteteve fqinje të Jugosllavisë së mbetur (Serbi dhe Mali i Zi), ministrja e Jashtme e Bullgarisë, Nadezhda Mihalova, i bëri të njohur ministrit të Jashtëm të Gjermanisë, Joshka Fisher, se shërbimi i fshehtë bullgar kishte siguruar dëshmi për planin operacional të serbëve për luftën në Kosovë, i cili me emrin e koduar "Operacioni Patkoi", ekzistonte që nga fundi i vitit 1998, sipas të cilit regjimi i Millosheviqit kishte planifikuar dëbimin me dhunë të shqiptarëve nga Kosova. Dëbimi do të përshejtohej nga grabitjet, vrasjet, përdhunimet, djegiet dhe terrori në shkallë të gjerë, ndërsa shqiptarëve të dëbuar nëpër kufij do t'u konfiskoheshin ose do t'u griseshin të gjitha dokumentet e identifikimit dhe targat e makinave, me qëllim që ata të mbeteshin pa shtetësi dhe të bëhej i pamundur rikthimi i tyre në Kosovë. Operacioni ishte planifikuar të zbatohet në tri faza: faza e parë ishte paraparë që të kryhej gjatë muajit janar 1999 dhe kishte për qëllim spastrimin etnik nga popullsia shqiptare e pjesës veriore të Kosovës. Faza e dytë ishte planifikuar të realizohej gjatë muajit shkurt dhe të përfshinte pjesën qendrore të Kosovës, përkatësisht Drenicën dhe rajonet përreth, me ç'rast, përveç vrasjeve dhe dëbimit të popullsisë shqiptare, synohej edhe shkatërrimi i

njësiteve të UÇK-së. Faza e tretë ishte paraparë të realizohej gjatë marsit dhe prillit 1999 dhe kishte për qëllim spastrimin e tërësishëm etnik të Kosovës. Ky plan serb për shfarosjen kolektive të shqiptarëve të Kosovës u bë sinonim i debateve në kryeqendrat ndërkombëtare, në konferencat për shtyp dhe në debate për arsyeshmërinë e ndërhyrjes së NATO-s si përgjigje ndaj kundërshtarëve të angazhimit ushtarak të Aleancës së Veriatlantikut në Kosovë. (Sylë Ukshini)

PLANI FISHER (12 prill 1999). Plan i ministrit të Jashtëm të Gjermanisë, Joshka Fisher, për zgjidhjen e problemit të Kosovës, i shpallur më 12 prill 1999. Plani kërkonte një zgjidhje diplomatike të konfliktit të Aleancës Veriatlantike me Jugosllavinë e mbetur, gjatë kohës së bombardimeve të NATO-s. Pavarësisht se reagimi ndaj kësaj nisme ishte i ftohtë, si në Uashington, ashtu edhe në Moskë, ky plan që mori karakterin e një nisme europiane, përmbante bazat për një zgjidhje politike. Me "Planin Fisher" OKB-ja duhej të merrte një rol qendror në procesin e bërjes së paqes dhe në organizimin e administrimit të përkohshëm të Kosovës. Në Samitin e NATO-s në Uashington, ministrat e jashtëm dhe ata të mbrojtjes të vendeve anëtare e miratuan planin e Fisherit si strategji zyrtare e Aleancës Veriatlantike. Një risi në "Planin Fisher" ishte synimi për aktivizimin e grupit G-8 (të 8 vendeve më të industrializuara), ku bënte pjesë edhe Rusia. Qëllimi ishte që, në bashkëveprim me Rusinë, të hartohej një rezolutë në Këshillin e Sigurimit, e cila do të mundësonte dhënien fund të sulmeve ajrore nën këto kushte: 1) Tërheqja e të gjitha forcave ushtarake, policore dhe paramilitare serbe nga Kosova; 2) Zotimi i UÇK-së për t'i dhënë fund sulmeve dhe për t'i dorëzuar armët; 3) Dislokimi në Kosovë i trupave paqeruajtëse ndërkombëtare nën udhëheqjen e NATO-s; 4) Kthimi i të dëbuarve dhe i refugjatëve; 5) Vendosja e Kosovës nën një administratë të përkohshme, derisa të jetë arritur një zgjidhje politike përfundimtare; dhe 6) Fillimi i programeve të ndihmës humanitare për zbutjen e gjendjes së rëndë dhe për rindërtimin e Kosovës. "Planin Fisher" përfshinte edhe fazat për implementimin e këtyre kushteve. Pasi Këshilli i Sigurimit i OKB-së ta shndërronte dokumentin në një rezolutë, do të niste zbatimin e hapave në terren. "Planin Fisher" nuk i referohej më Marrëveshjes

së Rambujesë, por shumë më tepër bazohej në opcionin e një zgjidhjeje kalimtare, administrim kalimtar deri në rregullimin përfundimtar të statusit politik të Kosovë. Gjatë një takimi të ministrave të jashtëm të grupit G-8 në Petesberg afër Bonit, më 6 maj 1999, do të merret në shqyrtim "Plani-Fisher" dhe do të arrihet pajtimi për parimet bazë të zgjidhjes politike. (Sylë Ukshini)

PLANI GJITHËPËRFSHIRËS I MARTI AHTISARIT. Plan i finalizuar gjatë negociatave për zgjidhje të statusit të Kosovës (negociatat e Vjenës). Është përgatitur nga përfaqësuesi i posaçëm i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së për çështje të statusit të ardhshëm të Kosovës, Marti Ahtisari. Në shkurt të vitit 2007, Marti Ahtisari ia dorëzoi planin e tij presidentit të Serbisë, Boris Tadiq, në Beograd dhe presidentit të Kosovës, Fatmir Sejdiu, në Prishtinë. Planin ia dorëzoi edhe Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, ndërsa ky, bashkë me aprovimin e tij, në mars të vitit 2007 ua vuri në dispozicion anëtarëve të Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Plani nuk u diskutua dhe nuk u votua në Këshillin e Sigurimit, kurse u refuzua nga pala serbe. Autoritetet kosovare pranuan t'i përfshinin në sistemin kushtetues dhe ligjor zgjidhjet e parapara me këtë plan. Plani parasheh statusin ndërkombëtar të Kosovës në formë të pavarësisë së mbikëqyrtur për një periudhë kohore, duke e njohur të drejtën e Kosovës për t'u bërë pjesë e organizatave ndërkombëtare dhe për të lidhur marrëveshje ndërkombëtare. Ai po ashtu përcakton strukturën e shtetit të Kosovës dhe hap rrugën për shpalljen e pavarësisë. Plani përmban 15 nene, në të cilat shtrohen parimet e përgjithshme, ndërsa në 12 shtojcat e tij janë elaboruar aspekte të ndryshme statusore. Plani i detajuar, tanimë pjesë e sistemit kushtetues të Kosovës, përmban dispozita kushtetuese, dispozita për të drejtat e komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre dhe përfshin decentralizimin dhe qeverisjen lokale, sistemin gjyqësor, trashëgiminë fetare dhe kulturore, borxhin ndërkombëtar, pronën dhe arkivat, sektorin e sigurisë, përfaqësuesin civil ndërkombëtar, misionin e BE-së për sundimin e ligjit, praninë ndërkombëtare ushtarake dhe agjendën legjislativë. Plani i Ahtisarit pasqyron idealin e një demokracie shumëetnike, duke e vënë në qendër sundimin e ligjit, respektimin e të drejtave të njeriut dhe

të lirive themelore. Ai parasheh mekanizma të shumtë të mbrojtjes së të drejtave të pakicave, përfshirë decentralizimin e gjerë dhe fuqizimit të autoriteteve lokale, përfaqësimin e garantuar parlamentar, mekanizmat e votimit, të cilat favorizojnë pakicat, përfaqësimin e garantuar të pakicave në Qeveri, në Gjykatën Kushtetuese, në Gjykatën Supreme dhe në institucionet e tjera të larta të vendit, sikundër edhe garantimin e përdorimit të lirë të simboleve dhe ruajtjen e identitetit etnik. Si formë e garantimit të të drejtave për komunitetet pakicë, plani kufizon mundësitë e ndryshimeve të mëvonshme kushtetuese, duke imponuar mekanizmin e shumicës së dyfishtë. Mbikëqyrja e zbatimit të Planit (deri në gjysmën e vitit 2012) i ishte lënë Zyrës Civile Ndërkombëtare, si mekanizëm i krijuar enkas për këtë qëllim. Plani parashton edhe kornizën e pranisë së ardhshme të BE-së në Kosovë, përmes misionit të sundimit të ligjit, me qëllim të përkrahjes së autoriteteve vendore, si dhe hapat e rishikimit të sistemit të sigurisë. (Iliir Dugolli)

PLASJA. (*Anthrax*) Sëmundje infektive septikemike, kryesisht e kafshëve bimëngrënëse. Sëmundja veçohet me gjakderdhje, shpretkë të rritur e të zbutur, gjak të pakoagulluar me ngjyrë më të errët, ngjashëm me katranin. Te kafshët shfaqen edema të ftohta hemorragjike nën lëkurë, seroza dhe mukoza me shumë eksudat në të gjitha hapësirat seroze. Shkaktar i sëmundjes është bakteri *Bacillus anthracis*, i cili në organizmin e kafshës së gjallë formon kapsulë, ndërsa jashtë organizmit spore shumë të qëndrueshme. Sëmundja në Kosovë shfaqet te dhentë, te gjedhi, te dhitë, te kuajt, ndërkaq më rrallë te derrat, te qentë dhe macet. Burime të sëmundjes janë kufomat e kafshëve të ngordhura nga plasja, në rast se ato nuk groposen, kullotat, stallat dhe uji. Bakteri hyn në organizmin e kafshës nëpërmjet ushqimit ose ujit të ndotur e rrallëherë nëpërmjet lëkurës. Inkubacioni i sëmundjes zgjat 1-3 ditë. Simptomat e sëmundjes janë marramendja e kafshës, lëkundja gjatë ecjes, kërcitja e dhëmbëve, gjakderdhja nga vrimat natyrale, urina dhe fecesi me gjak dhe ngordhja brenda disa orëve. Kafsha e sëmurë ka temperaturë të lartë 40-42.5°C, përfshirë edhe frymëmarrjen e shpesh-tuar, dridhjen dhe shqetësimin. Nga sëmundja ngordhin deri 90% e kafshëve të infektuara. Diagnostikimi i sëmundjes bëhet me metoda

epizootologjike, klinike dhe bakteriologjike. Mjekimi i kafshëve të sëmura bëhet me serum dhe antibiotikë. Shfaqja e sëmundjes pengohet me zhdukjen e kërmave të kafshëve (me përpunim teknik, groposje në varreza të kafshëve, djegie etj.) dhe me imunizim të të gjitha kafshëve të prekshme. (Xhevat Domi)

PLEQËSIA E ARSIMIT. Organ i Kuvendit të Kosovës, kompetent për çështje të arsimit. U themelua në vitin 1969. Me Ligjin themelor për Pleqësinë e Arsimit (1970), ky organ ishte kompetent për miratimin e planeve dhe programeve për edukimin parashkollor, fillor dhe të mesëm, për konceptimin e teksteve shkollore dhe lejimin për botim e përdorim, për përcaktimin dhe miratimin e normativave të lokalit shkollor etj. Me Ligjin e Pleqësisë së Arsimit të vitit 1975, ky organ fiton pavarësi të plotë në punën e tij. Kompetencat e Pleqësisë do të shtohen edhe me ligjin përkatës të vitit 1988. Pas rrënimit të autonomisë së Kosovës, Kuvendi i Serbisë, në janar 1990 miratoi Ligjin mbi Pleqësinë e Arsimit të Serbisë, me të cilin i shfuqizoi të gjitha vendimet e organeve arsimore të Kosovës, duke përfshirë edhe vendimet e Pleqësisë së Arsimit. Pleqësia e Arsimit e Kosovës veprimtarinë e vet e vazhdoi edhe në kushte të jashtëzakonshme. Më 26 qershor 1990 miratoi vendimin, sipas të cilit “Organizatata arsimore-edukative në Krahinën Socialiste Autonome të Kosovës në vitin shkollor 1990/91 të punojnë sipas plan-programeve dhe teksteve ekzistuese, përderisa Krahina t’i nxjerrë ligjet e veta përkatëse.” Pleqësia e Arsimit e Kosovës dha një kontribut të çmuar për mbijetesën dhe pavarësimin e arsimit shqip në Kosovë. (Islam Krasniqi)

PLEQNARËT. Sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit pleqnarët janë të parët e vëllazërive apo krerët e fiseve, të cilët kishin të drejtë ta mënjanonin çdo mosmarrëveshje dhe kërcënim dëmsh, ose kërcënim për vrasje, “ku me urti, ku me fuqi”, bashkë me gjithë fshatin. Për të nisur pleqninë, duhej lëshuar “pengu”. Ai që lëshonte i pari pengun, shtrinte pushkën për tokë, vinte dorën mbi të dhe shqiptonte fjalët: “Unë e lëshova pengun!” Ky veprim dëshmonte, së pari, se personi hiqte dorë nga forca dhe i nënshtrohej arsyes, gjykimin sipas kanunit, pra pleqnisë; së dyti, se nuk kishte frikë, përderisa dorën e kishte te pushka. Edhe pala tjetër ishte

e detyruar me kanun t’i përgjigjej pengut. Atëherë ndërhyenin pleqtë, të cilët zgjidheshin nga palët, që ishin më të zotët dhe që pranonin të ndanin pleqninë e kërkuar. Varësisht nga natyra e çështjes së shtruar për zgjidhje, pleqnia mund të zgjaste disa orë ose disa ditë. Ndodhte që të dy palët t’ia ngarkonin pleqninë të njëjtit person, pra, të merrnin vetëm një plak. Pleqtë, si kryenin hetimet e nevojshme, binin në ujdi me njeri-tjetrin, njoftonin palët që të dëgjonin “ndamjen” e pleqnisë. Palët që pranonin “të damët” e pleqve, përgjigjeshin me fjalët: “Sa qofshi, pleqnofshi” dhe çështja mbyllej. Detyrimi i pleqve ishte të mos mbanin anën e askujt. Nëse ndodhte që këto detyrime të shkeleshin nga ndonjëri prej pleqve, ai nuk zgjidhej më në kanunin e pleqnisë. (Bashkim Lajçi)

PLEQNITË. Tregim për ngjarje juridike, të cilat janë gjykuar në bazë të traditës, duke u mbështetur në normat e së drejtës zakonore, kryesisht të Kanunit të Lekë Dukagjinit. Janë tregime për konfliktet e zgjidhura me sukses, që rrëfehen në oda të burrave, në ndeja të ndryshme etj. Nga rrafshi praktik, krijimi ka marrë gradualisht kahen e rrëfimit artistik. Pleqnitë u atribuohen personaliteteve të njohura, përkatësisht pleqnarëve të trevave të ndryshme, të cilët i kanë zgjidhur konfliktet në përshtatje me mentalitetin patriarkal të trevës së caktuar dhe me doket e zakonet e traditës. Në to trajtohet dendur dukuria e gjakmarrjes, ndorja, dhënia e besës, ndorja e gruas, çështja e ndërmjetësimit, respekti që i bëhet familjes së të vdekurit. Shumë nga pleqnitë përçojnë mesazhe universale. Pleqnitë i ka mbledhur, i ka botuar dhe i ka identifikuar si zhanër folklorik më vete prof. Anton Çetta në përmbledhjen “Pleqni dhe tregime etnografike” (1995). (Myzafere Mustafa)

PLINI (Gai Plin Secundi) (23/24-79. Autor antik romak. Lindi në Novum Komum (Itali e Veriut). Vinte nga shtresa ekuesteriane, që ishte anëtar i rendit aristokratik të ekuites. Gjatë sundimit të dinastisë së Flavëve ushtroi detyra të ndryshme të karakterit civil dhe ushtarak. Është autor i një varg veprash, si: “Mbi retorikën”, “Mbi artin ushtarak”, “Mbi historinë dhe filologjinë” etj. Këto vepra llogariten të humbura, ndërsa vepra e tij më e madhe “Historia e natyrës” i ka mbijetuar kohës dhe

përbëhet nga 37 libra. Në të gjenden të dhëna nga shkenca të ndryshme, duke u nisur nga gjeografia, fizika, zoologjia e të tjera. Kjo vepër është burim i rëndësishëm edhe për historinë, gjeografinë dhe ekonominë ilire, si dhe të asaj dardane në veçanti. (Emine Kalaja-Hajdari)

PLLANA Emin (1934 -2013). Historian, profesor universiteti. Lindi në fshatin Shtitaricë të Vushtrrisë. Shollën fillore e kreu në Vushtri, të mesmen në Gjakovë, kurse Shkollën e Lartë Pedagogjike, degën e historisë e kreu në Beograd. Më pas kreu edhe studimet e plota për histori në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Beogradit (1958). Në këtë universitet kreu edhe studimet pasuniversitare dhe mbrojti tezën e disertacionit (1973). Fillimisht punoi si mësimdhënës i historisë në Vushtri dhe më vonë në gjimnazin e Mitrovicës. Në vitin 1968 u zgjodh asistent dhe në vitet vijuese arriti titullin profesorit ordinar në degën e historisë të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Ka botuar tekste të historisë për shkolla fillore dhe të mesme dhe studimet monografike: “Kosova dhe reformat në Turqi (1839-1912)”, “Lëvizja punëtore ndërkombëtare deri në vitin 1945” (1984). Ka marrë pjesë në konferenca shkencore brenda dhe jashtë vendit. (Isa Bicaj)

PLLANA Gani (1954-). Inxhinier i makinerisë, mësimdhënës universitar. Lindi në Këq të Madh të komunës së Mitrovicës. Shkollën fillore e kreu në Smrekonicë, shkollën e mesme në Mitrovicë. U diplomua në Fakultetin Teknik të Universitetit të Prishtinës (1978), ndërsa studimet e magjistraturës i përfundoi në Fakultetin e Makinerisë dhe të Anijendërtimit të Universitetit të Zagrebit. Nga viti 1979 punon në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike të Universitetit të Prishtinës. Gjatë vitit akademik 1984/85 ishte për specializim në Luzanë të Zvicrës. U zgjodh ligjërues i lartë më 1996. Përveç në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike, ligjëroi edhe në Fakultetin e Xehetarisë dhe të Metalurgjisë, në shkollat e larta teknike në Ferizaj dhe Mitrovicë, në Universitetin e Tetovës dhe në Universitetin e Prizrenit. Publikoi një sërë artikujsh shkencorë nga fusha e inxhinierisë mekanike dhe e terminologjisë, në vend dhe jashtë. Është përkthyes i disa teksteve për shkolla të mesme profesionale, hartues i dispenseve dhe i teksteve universitare me përmbledhje detyrash nga mekanika teorike. (Xhevat Perjuci)

PLLANA Qerim (1944-2014). Shkrimtar. Lindi në fshatin Shtrojerë të Vushtrrisë. Kreu shkollën fillore në vendlindje, të mesmen në Vushtri, ndërsa studimet për letërsi dhe gazetari i mbaroi në Prishtinë. Disa vjet punoi në arsim, mandej në gazetën “Kosova” dhe, së fundi, përsëri në arsim. Është autor i një sërë veprash letrare (romane, poezi, publicistikë) dhe i një sërë shkrimesh të ndryshme nga kultura, letërsia dhe arti. Botoi veprat: “Erërat që s’prajnë” (1992), romanin “Legjenda e dasmës” (1962), “Metamorfozë shqiptare apo udhëkryq i ri kombëtar” (1993), “Tri hije në Bruksel” (1994), “U zhdukën bashkë me krismën” (1995), “Dilemat për bashkimin kombëtar” (1998), “Albanidë, toka ime e zjarrtë” (1998), “Pafundësi e përbotshme” (1908). Ka lënë në dorëshkrim edhe disa vepra letrare dhe publicistike. (Nazmi Rrahmani)

PLLANA Ruzhdi (1940-2015). Gjeograf, profesor universitar, anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës. Lindi në Dobërrllukë të Vushtrrisë. Kreu shkollën fillore në Vushtri dhe Normalen në Prishtinë (1960), ndërsa studimet për gjeografi i ndoqi në Universitetin e Novi Sadit (1966). Studimet pasuniversitare i kreu në Universitetin e Zagrebit (1973), kurse disertacionin e doktoratës e mbrojti në Universitetin e Prishtinës. Një kohë punoi në shkolla të mesme, pastaj u emërua ligjërues në seksionin e gjeografisë të Universitetit të Prishtinës (1971), ku shërbeu deri në pension (2005). Dha mësim në lëndët e klimatologjisë, meteorologjisë, hidrologjisë, gjeografisë nacionale, menaxhimit të mjedisit, gjeotrashëgimisë, rreziqet natyrore etj. Ushtri detyrën e përgjegjës të seksionit, të prodekanit të Fakultetit Filozofik, të kryetarit të Shoqatës së Gjeografëve, të redaktorit të revistës “Kërkime gjeografike” dhe të ndihmëssekretarit për arsimin të KSA të Kosovës (1985-1989). R. Pllana u mor posaçërisht me problemet e ujërave, të klimës, të mjedisit, të rreziqeve natyrore dhe të speleologjisë (shpellave). Për thellimin e njohurive nga këto fusha ka qëndruar në Institutin e Hidrometeorologjisë në Tiranë (1973), në Bërno të Çekosllovakisë (1975), në Institutin



RUZHDI PLLANA

“Lomonosov” në Moskë (1979), në institutet për çështje të mjedisit në Britani të Madhe, Holandë, Poloni etj. R. Pllana ka botuar një varg punimesh shkencore në revistat vendore dhe ndërkombëtare, si dhe katër tekste mësimore të gjeografisë. Është autor i teksteve për klimën, ujërat dhe trashëgiminë natyrore në botimin “Kosova-vështrim monografik” (2013) dhe i monografisë “Klima e Kosovës” (2015). (Vahdet Pruthi)

PLLANA Shefqet (1930-1994). Mledhës dhe studiues i folklorit, profesor universiteti. Lindi në Ferizaj. Kreu Shkollën Normale në Prizren, ndërsa studimet në katedrën e albanologjisë të Universitetit të Beogradit (1957), ku kreu dhe studimet pasuniversitare dhe mbrojti tezën e doktoratës (1970). Në vitet 1968-1991 ligjëroi lëndën e letërsisë popullore në degën e letërsisë shqipe të Universitetit të Prishtinës (UP). Në periudhën 1988-1991 ishte dekan i Fakultetit të Filologjisë të UP-së, kur u përjashtua me dhunë nga puna nga autoritetet serbe. Vepra e tij “Studime në fushë të folklorit” u botua pas vdekjes, që është një përzgjedhje studimesh e përgatitur nga një redaksi e veçantë në Fakultetin e Filologjisë në Prishtinë (2004). Sh. Pllana ka mbledhur dhe redaktuar lëndë të shumtë folklorike dhe ishte bashkautor në përgatitjen e vëllimit “Këngë popullore të Rilindjes Kombëtare” (1978). Themeloi dhe udhëhoqi për një kohë të gjatë Shoqatën e Folkloristëve të Kosovës. Mori pjesë me kumtesa në shumë kongrese e simpoziume të ndryshme brenda dhe jashtë vendit. Duke ligjëruar për shumë vjet lëndën e letërsisë popullore, Sh. Pllana ka merita të veçanta për përgatitjen e kuadrit nga fusha e folkloristikës në Kosovë dhe në hapësirat shqiptare të ish-Jugosllavisë. (Adem Zejnullahu)

PLLANA Teuta (1959-). Pianiste. Lindi në Prishtinë. Mësimet e para për piano i mori te pedagogët H. Gjinali, më pas tek I. Juniku në Shkollën e Ulët dhe në Shkollën e Mesme të Muzikës në Prishtinë. Kreu studimet për piano më 1982 në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. Përfundoi specializimin njëvjeçar në Moskë më 1985-1986 te prof. V. Natanson dhe A. Malkus. Koncertoi në festivale të njohura në vend dhe në qendra të ish-Jugosllavisë, si në “Ditët e Muzikës Kosovare”, “Skena Muzikore e Prishtinës”, “Ditët e Muzikës” në Herceg-

Novi, “Tribuna e Krijimtarisë Muzikore” në Opati etj. Bashkëpunoi me instrumentistë të njohur kosovarë. Koncertoi edhe në Gjermani, Francë (Parsi, 1989, 200-vjetori i Revolucionit Frëng), në Shqipëri e SHBA. Ligjëroi lëndën e pianos në Fakultetin e Arteve dhe në Shkollën e Muzikës në Prishtinë. Më 1990 u shpërngul në SHBA. Bashkëpunon me pianisten ruse L. Kritskaya. Nga viti 2011 mban mësimet e pianos në “Long Island University”. Jeton dhe vepron në Nju-Jork. (Indira Çipa)

PNISHI Shani (1977-). Gazetar. Lindi në Demjan të Gjakovës. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje dhe në Gjakovë. Studimet për letërsi dhe gjuhë shqipe i mbaroi në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës. Një kohë punoi në gazetën e studentëve “Bota e re”. Në vitin 1999 emigroi në Kanada, ku kreu studimet për shkencë politike në Universitetin e Hamiltonit. Ishte korrespondent nga Kanadaja i gazetës shqiptaro-amerikane “Illyria” dhe më pas kryeredaktor i gazetës “Flas shqip” që botohet në Kanada. Në periudhën 2010-2015 ka drejtuar shoqatën e shqiptarëve në Hamilton. Merret edhe me letërsi. Në vitin 1999 botoi përmbledhjen e poezive “99”. Jeton në Kanada. (Hyra Tejeci)

PODGURI I PEJËS. Trevë gjeografike në pjesën veriore të Rrafshit të Dukagjinit. Ndryshe njihet si Anamali i Pejës. Shtrihet rrëzë malit Mokna, në kontaktin ndërmjet fushës së Dukagjinit dhe malit të Mognës. Lartësia mbidetare është mbi 450 metra, që njëherësh paraqet pjesën më të ngritur të Fushës së Dukagjinit. Në aspektin gjeologjik, Podguri, në pjesën e poshtme të tij (rrëza), përbëhet nga formacioni vullkanogjen diabaz-strallor, ndërsa në pjesët më të larta nga gëlqerorët, dolomitët e triasikut. Karakterizohet edhe me relief sipërfaqësor karstik. Në kontaktin e këtyre formacioneve gjeologjike, në rrëzën e tij burojnë gurrat e Vrellës, Istogut, burimi termal i Studenicës etj. Temperatura mesatare vjetore sillet nga 9-10°C, kurse reshjet mes 800-900 mm. Podguri është relativisht i mbuluar me bimësi, ku mbizotëron dushku. Përgjatë kësaj treve kalon rruga magjistrale Mitrovicë-Pejë, duke u mundësuar banorëve qasje më të shpejtë në komunikacion dhe lidhje me vendbanimet e komunës së Pejës e të Istogut. Në këtë trevë janë të vendosura vendbanimet

pranëmalore: Istogu, Vrella, Studenica, Mojtiri etj. Banorët merren me veprimtari të dyfishtë, duke shfrytëzuar fushën për bujqësi, kurse zonat malore për blegtori dhe pylltari. Dita-ditës rëndësi më të madhe po i kushtohet pemëtarisë. Qendra kryesore është Istogu (Burimi), me 5,115 banorë. (Valbon Bytyçi)

PODRIMÇAKU Avdi (1951-). Gazetar. Lindi në fshatin Fierzë të komunës së Pejës. Në vendlindje kreu shkollën fillore, të mesmen në Pejë, ndërsa studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Filloi të merret me gazetari në të përditshmen “Rilindja” nga viti 1976. Ndoqi kryesisht zhvillimet në fushën e ekonomisë dhe, në këtë kuadër, problematikat e bujqësisë dhe të fshatit. Një periudhë punoi edhe në redaksinë e gazetës “Rilindja” që u botua në Tiranë. Nga viti 1999 jeton në Suedi. (Shefqet Rexhepi)

PODRIMÇAKU Drilon (1985-). Balerin. Lindi në Prishtinë. Shkollën fillore dhe shkollën e mesme të muzikës “Prenk Jakova”, degën e baletit, e kreu në Prishtinë. Në Trupën e Baletit të Kosovës në Teatrin Kombëtar është i angazhuar që nga viti 2003, prej kur ka luajtur në një sërë shfaqjesh. (Ragip Sylaj)

PODRIMÇAKU Hysen (1953-). Balerin. Lindi në Novosellë të Pejës. Shkollimin fillor e kreu në vendlindje, ndërsa Shkollën e Mesme të Baletit në Shkup. Pas diplomimit më 1972 filloi punën në Teatrin Popullor Krahinor, si gjeneratë e parë e trupës së baletit në Kosovë. Mori pjesë në një sërë premierash të realizuara nga ansambli i baletit dhe në shfaqje të realizuara nga ansambli i dramës. Bashkë me ansamblin e baletit u prezantua në festivalet ndërkombëtare, si në “Bienalet e Lubjanës” në Slloveni dhe “Lojërat e Dubrovnikut” në Kroaci. Luajti rolet kryesore në shfaqjet e baletit: “E bukura More”, “Era dhe kolona”, “Balloja e kadetëve”, “Bukuroshja e fjetur”, “Fyelltari” etj. Nga viti 2000 ligjëroi lëndën e baletit klasik në Shkollën e mesme të muzikës “Prenk Jakova” në Prishtinë dhe në Shkollën e mesme të muzikës “Lorenc Antoni” në Prizren. (Selman Jusufi)

PODRIMJA. Njësi e vogël administrative që nga fundi i shek. XII, e cila përfshinte hapësirën në të majtë të Drinit në drejtim të

Prizrenit dhe pjesën më të madhe të territorit të komunave të sotme të Rahovecit dhe të Hoçës së Madhe. Në jetëshkrimin e Stefan Nemanjës, të hartuar nga i biri Rastko, përkatësisht Shën Sava (rreth vitit 1220), mësohet se Nemanja në një ekspeditë bashkë me mbretin hungarez, pasi rrënoi qytetin e sotëm të Sofjes, me t'u kthyer në principatën e vet kishte rrënuar edhe qytetet e Stobit, Velbuzhdit, Shkupit, qytetin Leshi në Pollog dhe qytetin e Prizrenit, duke ia bashkëngjitur të gjitha këto territore principatës së vet. Krahina e vogël e re (zhupa), e themeluar me këtë rast, u quajt nga ardhësit serbë Podrima/Podrimlje, sipas pozitës së mikroregjionit nën rrjedhën e poshtme të Drinit të Bardhë, me qendër Rahovecin e sotëm. Për ndryshim nga emrat e zhupave të tjera, ky variant serb i emrit u ruajt dhe u vazhdua edhe nga popullata vendëse arbërore, e cila para ngulitjes së serbëve ishte popullsi shumicë. (Skënder Gashi)

PODRIMJA Ali (1942-2012). Poet, akademik. Lindi në Gjakovë. Kreu shkollën fillore dhe të mesme në vendlindje. Mbaroi studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin Filozofik



ALI PODRIMJA

në Prishtinë. Në fillim u punësua si gazetar në të përditshmen “Rilindja”, më vonë redaktor në ndërmarrjen e botimeve “Rilindja”, ku punoi deri në pensionim. Poezinë e parë “Bukuria” e botoi në vitin 1959, me të cilën tërhoqi vëmendjen e atëhershme, si talent i veçantë. Librin e parë “Thirrje” e botoi në vitin 1961. Veprat letrare: “Thirrje” (1961), “Shamijat e përsëndetjeve” (1963), “Loja nën diell” (1967), “Dhimbë e bukur” (1967), “Sampo” (1971), “Hija e tokës” (1971), “Sampo 2” (1980) “Folja” (1973), “Credo” (1976), “Poezi” (1978), “Poema” (1978), “Drejtpeshimi” (1981), “Lum Lumi” (1982), Fundi i gëzuar (1988), “Zari” (1990), “Në bisht të sorrës” (1994), “Buzëqeshje në kafaz” (1994), “Ishulli Albania” (1998), “Harakiri” (1999), “Dielli i zi” (2000), “Libri që nuk mbyllet” (2001), “Ëndrrat kallëzohen në mëngjes” (2001), “Litari i ankthit” (2002) “Antologji personale” (2003), “Te guri i Prevezës” (2003), “Libri mbi të qenit” (2009), “Kush do ta vrasë ujkun” (2002). Formimi

shpirtëror dhe intelektual i A. Podrimjes u krijua në vitet '50 të shekullit njëzet. Gjurmë të thellë do të lërë, sidomos, aksioni famëkeq serb për mbledhjen e armëve dhe shpërnguljen dramatike me dhunë nga Kosova për në Turqi. Si gjimnazist, por edhe më tej, ai do të zhvillojë një betejë të madhe deri në fund të jetës edhe përmes poezisë. Poezia e A. Podrimjes është e mbujtur me fatkeqësitë kolektive të etnisë, por edhe me ato personale, me të cilat do të përballet pambarimisht. I ndërgjegjshëm për përcaktimin e brendshëm, për misionin e madh të cilit tërësisht i dorëzohet, me guxim dhe dinjitet, A. Podrimja është plotësisht i vendosur dhe i sigurt për sa dëshiron, për sa beson, për misionin e vet, duke e artikuluar tërë atë revoltë përmes zërit poetik të fuqishëm, që sa vjen e pushton hapësirën shqiptare. Në njëzet e më shumë vëllime poetike, por edhe në disa vëllime funksionale eseistike - në frymën gjithnjë të poezisë së tij, ai do t'i prekë dhe do t'i përvijojë majat e poezisë shqipe. Në një hark kohor prej më se dyzet vjetësh, A. Podrimja do t'i qëndrojë besnik projektit madhor poetik. Brenda këtij projekti ai do ta vijëzë edhe synimin kolektiv: do të jetë rapsodi i madh shqiptar, ai i zërit të këngës integrale në kohë dhe hapësirë, zë i të gjitha të pathënave shqiptare gjatë shekujve të kaluar, i shekujve të durimit dhe të heshtjes. Në lartësinë artistike poezia e A. Podrimjes shkëlqen misionare. Ajo ka gjakuar të jetë zë i dhembjes kolektive kosovare, zë i mprehtë, i qëndrueshëm, duke e universalizuar atë. Tërë vepra si e tillë, shumë herë do të dalë përtej gjuhës shqipe, si vlerë gjithënjëzore, kudo që u botua. E përkthyer në shumë gjuhë të botës, poezia e A. Podrimjes do të laureohet me çmime të larta ndërkombëtare dhe kombëtare. Poezia e tij frymëzoi dhe nxiti breza poetik të shqipes, frymëzoi lëvizjet e të rinjve drejt lirisë dhe vlerave shpirtërore. Ishte laureat i një sërë çmimesh letrare dhe mirënjohjesh publike. (Ali Aliu)

PODUJEVA (BESIANA). Qytet në verilindje të Kosovës, qendër e komunës me të njëjtin emër. Shtrihet në të dy anët e lumit Llap, në lartësi mbidetare 620 m, në një sipërfaqe prej 914 ha. Afër Podujevës janë identifikuar dy vendbanime të rëndësishme ilire: Vendenisi, 5 km në të djathtë të lumit Llap dhe Laberion, në jug, më pranë qytetit. Podujeva përmendet për herë të parë në defterin kadastral osman



PODUJEVA

të vitit 1455 dhe në një dokument të arkivit të Dubrovnikut të vitit 1660. Fillet e para të fizionomisë dhe jetës urbane Podujeva i merr në fund të shekullit XIX. Në fillim të shekullit XX në Podujevë filluan të hapen disa dyqane tregtare. Kësaj i parapriu vendosja e disa familjeve tregtare, kryesisht nga Gjakova. Gjatë viteve 1878-1881, në Podujevë dhe rrethinë u vendosën një numër refugjatësh nga Toplica. Pas vitit 1913 në Podujevë vendosen kolonët e parë serbë, ndërsa popullsia shqiptare përjeton disa shpërngulje radhazi për në Turqi. Qyteti i Podujevës pati fatin e ngjashëm me shumë vendbanime të tjera të Kosovës, të cilët gjatë kohës sa ishin nën sundimin serb, disa herë u dogjën dhe u shkatërruan. Sipas regjistrimit të vitit 1981, Podujeva kishte 15,937 banorë, ndërsa në vitin 2000 kishte 27,500 banorë. Në vitin 2011 në Podujevë u regjistruan 23,453 banorë. Dega kryesore e ekonomisë së kësaj zone është bujqësia, ndonëse janë ngritur edhe disa kapacitete të industrisë ndërtimore, të plastikës etj. Nga objektet e standardit shoqëror, Podujeva ka qendrën e mjekësisë familjare, pesë shkolla fillore, tri shkolla të mesme, dy radio lokale dhe një numër të objekteve tregtare dhe shërbyese. (Skender Halimi)

PODUJEVA (BESIANA) (komuna). Shtrihet në verilindje të Kosovës, në lartësi mesatare mbidetare 825 m. Kufizohet me komunën e Prishtinës në jug, me Obiliqin e Vushtrrinë në jugperëndim dhe me Mitrovicën në perëndim, në veriperëndim kufizohet me komunën e Leposaviqit, ndërsa në lindje me Serbinë. Sipërfaqja e territorit të komunës është 633 km², ku jetojnë 131,300 banorë, në 76 vendbanime, me dendësi mesatare 207 b/km². Qafat malore dhe grykat mundësojnë

lidhje të mira komunikuese me komunitet dhe rajonet e tjera të Kosovës. Nëpër qafën e Merdarit (647m) kalon rruga automobilistike ndërballkanike Durrës-Kukës-Merdar-Nish, e cila paraqet korridorin më të shkurtër dhe më efikas për lidhjen e bregdetit Adriatik me brendësinë e Gadishullit Ballkanik dhe anasjelltas. Me Prishtinën dhe Rrafshin e Kosovës lidhet përmes grykës së Kulinës (Teneshdollit). Komuna e Podujevës ka klimë të mesme kontinentale. Temperatura mesatare e ajrit është rreth 9.5°C. Për shkak të strukturës morfologjike të terrenit, të hapjes nga ana e veriut, të lartësisë së madhe mbidetare dhe të pjesëmarrjes së madhe të territorit kodrinor-malor, klima ka veçori më të theksuara kontinentale në krahasim me pjesët e tjera të Kosovës. Popullsia e komunës ka shënuar rritje të vazhdueshme. Sipas të dhënave të Agjencisë Statistike të Kosovës, numri i popullsisë në komunën e Podujevës në vitin 2014 ishte 131,000 banorë, ndaj 41,834 banorëve sa kishte në vitin 1948. (Skender Halimi)

PODGORICA Afërdita (1978-). Futbolliste, trajnere. Lindi në Podujevë. Në vitin 1993 emigroi në Gjermani, së bashku me familjen. Fillimisht u regjistrua në klubin e "Traber FC Mariendorf" dhe pas dy vjetësh u bashkua me "SSV Turbinë Potsdam". Një pjesë të karrierës e kaloi edhe në "Wolfsburg", e më pas u rikthye përsëri në "Potsdam". Pas disa lëndimeve që pësoi, në vitin 2009 e përfundoi karrierën në "Potsdam". Pati një karrierë të suksesshme, duke u bërë shqiptarja e parë që bëri emër në futbollin evropian. Ajo fitoi kupën UEFA-s për femra në vitin 2005, dy herë u shpall kampione e Gjermanisë (2004 dhe 2006), si dhe tri herë fitoi kupën e Gjermanisë (2004, 2005 dhe 2006). Punon ndihmëstrajnere në skuadrën gjermane "Turbine Potsdam". (Florim Maliqaj)

PODGORICA Fetah (1968-). Kimist, profesor universiteti, anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (ASHAK). Lindi në Dumosh të Podujevës. Shkollimin bazë e kreu në Podujevë, studimet për kimi në Universitetin e Prishtinës (1993), studimet pas-universitare dhe tezën e disertacionit e mbrojti në Universitetin "Parisi 7" (2000). Në vitin 1993 zgjidhet asistent në departamentin e kimisë të Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore (FSHMN) të Universitetit të Prishtinës (UP)



FETAH
PODGORICA

dhe më vonë, po në këtë fakultet, gradohet në të gjithë titujt universitarë. Kreu disa detyra në institucionet e arsimit të lartë. Ligjëroi lëndën e kimisë së përgjithshme në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit Paris 7 (1998-2000). Është anëtar

i rregullt i disa shoqatave ndërkombëtare të kimistëve dhe ka qenë profesor i ftuar në Shkollën e Lartë për Fizikë dhe Kimi (ESPCI) të Parisit dhe ka marrë habilitimin për udhëheqje në hulumtime shkencor (2010). Ka publikuar punime shkencore në revista ndërkombëtare dhe ka mbajtur kumtesa në tubime shkencore. Ka të regjistruar dy patenta në Europë dhe në SHBA. Është përfshirë si bashkautor në bibliografinë e botimeve për kripërat e aril diazonumit. Është shpallur shkencëtar i vitit 2013 nga Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë të Kosovës. Në vitin 2016 u zgjodh anëtar korrespondent i ASHAK-ut. (Nexhat Daci)

PODGORICA-JASHARI Elife (1965-). Solokëngëtare. Lindi në Dumosh të Podujevës. Pas shkollës së mesme kreu solokëndimin në Fakultetin e Arteve në Prishtinë, (1988), kurse magistraturën në Shkup (2007-2009). Njihet si këngëtare e muzikës popullore, artistike e serioze. Është paraqitur në festivale dhe ka koncertuar me artistë e orkestra të njohura. Disa nga paraqitjet e saj janë: Vendi i parë në garat federative të ish-Jugosllavisë (Valevë, 1984); Koncert recital solistik (Maribor, 1998); Festivali II i Muzikës Kamerale (Prishtinë, 2001); koncert me Filarmoninë e Kosovës në Zvicër (2007), si dhe koncerte të ndryshme në Kosovë, Itali, Austri, Slloveni, Hungari, Gjermani etj. Nga viti 1987 ishte soliste në Korin Profesional të Radiotelevizionit të Prishtinës, kurse nga viti 1990 disa vjet soliste në Korin Shtetëror në Slloveni. Ishte profesore e solokëndimit në Shkollën e Muzikës në Prishtinë, bashkëpunëtoresh e jashtme për teknikë vokale në Fakultetin të Arteve (2001-2008) etj. (Kristina Palokaj-Përkola)

POEZIA. Në korpusin letrar shqiptar, poezia është forma më e pranishme artistike, e cila, me rrënjë në traditën popullore, njeh rrymat dhe stilet e ndërliqshme të saj. Kur kemi në

fokus hapësirën e Kosovës, poet i parë del Pjetër Bogdani, i cili te “Cuneus Prophetarum”, shkroi poezitë religjioze për Sibilat. Në vijimësi shquhen Gjon Nikollë Kazazi, për katekizmin, e Ndue Bytyçi për vargjet kushtuar atdheut. Shtjefën Gjeçovi, te revista “Albania”, në vitet 1901-1902 botoi poezitë atdhetare me pseudonimin Lkeni i Hasit. Por, librat e parë të botuar në Kosovë i hasim mbas Luftës së Dytë Botërore. Martin Camaj botoi veprat “Një fyell ndër male” (1953) dhe “Kanga e vërrinit” (1954), si himn për vendlindjen dhe natyrën. Poezinë e re të angazhuar me synim realizimin e lirisë e shkruan Esad Mekuli në veprën “Për Ty” (1955). Këto dy modele letrare do të kenë ndikim në vitet ‘60, sidomos tek autorët: Enver Gjerqeku, Din Mehmeti, Fahredin Gunga, Azem Shkreli, Ali Podrimja, etj. Enver Gjerqeku botoi veprat poetike “Gjurnat e jetës” (1957) e “Blerimi i vonuem” (1966) si forma elementare për të arritur në realizimin e sonetit. Din Mehmeti botoi veprat “Në krahët e shkrepave” (1961), “Dridhjet e dritës” (1969), ku dominon verbi i nostalgjisë për vendlindjen, i realizuar me figurat e ironisë e të kontrastit. Adem Gajtani botoi veprat “Drita në zemër” (1961), “Ti këngë, ti zog i largët” (1968) si latim metaforash e simbolesh. Fahredin Gunga sjell veprat poetike “Pëshpëritjet e mëngjezit” (1961) dhe “Mallkimet e fjetuna” (1970) si figurim rrethanash me synim simbolesh. Azem Shkreli, në nisje me frymën e Camajt, botoi veprat “Bulzat” (1960), “E di një fjalë prej guri” (1969) si këngë për vendlindjen e për unin poetik. Rrahman Dedaj me veprat “Me sy kange” (1962), “Baladë e fshehur” (1970) sjell shtimung të ri motivesh, figurash e refleksionesh poetike. Ali Podrimja nisat me veprën e angazhuar “Thirrje” (1961) për të vijuar me “Shamijat e përshëndetjeve” (1967), “Sampo” (1969), ku dëshmon lakoren ngritëse në jetësim të metaforës kontrastive. Beqir Musliu me veprat “Rima të shqetësuese” (1965), “Bukurija e zezë” (1968) hap reflektime metafizike e figurë misticizmi. Avancimi nga poezia subjektive ndodh në vitet ‘70 me shfaqjen e poetëve Eqrem Basha, Sabri Hamiti, Teki Dërvishi, Musa Ramadani, Nexhat Halimi etj, të cilët krijojnë poezi objektive, për t’u shndërruar në model letrar. Të njohur me poezinë evropiane e botërore, të vetëdijshëm për estetikën letrare etabluan poetikën e individualiteteve letrare. Eqrem Basha me

veprat “Opuset e maestros” (1971), “Yjedet” (1977) etj., hulumton në honet meditative të njeriut të humbur. Sabri Hamiti me veprat “Njeriu vdes i ri” (1972), “Thikë harrimi” (1975) e “Trungu ilir” (1979) etj., nis sistemin poetik si vetënjohje deri te rinjohja etnike-nacionale. Teki Dërvishi me vepat poetike “Nimfa” (1970), “Shtëpia e sëmurë” (1978) etj., sjell poetikën e sinkretizimit të formave shprehëse. Musa Ramadani me vepat “Mëkatet e Adamit” (1969), “Neurosis” (1973) etj., figuron mëkatit njerëzor e gjendjet poetike neurotike. Nexhat Halimi me veprat “Parakalimi i etjeve” (1969), “Dita e daljes” (1978) sjell figurën e paradoksit e semantikën e imazheve. Edi Shukriu sforcion poezinë e burimësisë arkeologjike te vepra “Gjakim” (1979). Këtyre individualiteteve poetike u shtohen veprat e autorëve të brezit pararendës, nga të cilat veçojmë: sistematikën sonetike të Gjerqekut, poezitë ambientale të Din Mehmetit, vijimin e lirizmit të Adem Gajtanit, sforcimin e simboleve të Fahredin Gungës, poezitë e unit e të paradoksit të Azem Shkrelit, poezitë e figuracionit subtil të Rrahman Dedajt, e refleksiviteti poetik i Ali Podrimjes. Poezia e Kosovës hyn në ndërkomunikim modern poetik. Ndërkaq, autorët e viteve ‘60-‘70, sidomos Ali Podrimja, Sabri Hamiti, Eqrem Basha vijnë në sistematikën krijuese, duke shtuar laryshinë e formave dhe të motiveve poetike. Ali Podrimja shquhet me “Torzon” (1971) dhe “Lum Lumin” (1982) si latim figure e shprehje të emocionit, Sabri Hamiti me “Leja e njohtimit 1985” (1985) e “Kaosmos” (1990) si dominancë e figurës mendimtare, Eqrem Basha me veprat “Atleti i ëndrrave të bardha” (1982) dhe “Udhë qumështore” (1986) si dëshmi ëndërimi e pësimi njerëzor. Ky korpus poetik plotësohet me veprat e autorëve të brezit vijues si Abdullah Konushevc, Ramadan Musliu, Basri Çapriqi etj. Abdullah Konushevc me veprat poetike “Pasqyrë dhe diell” (1979), “Qerrja e diellit” (1983) etj, poetizon dhembje personale dhe risemantizime historike. Ramadan Musliu me veprat “Parodia e trupit” (1981), “Pasqyra e të rrëfyerit” (1987) situon asociacione figurash me zëra nga etnia. Basri Çapriqi me veprat “Ulli me dymijë unaza” (1983), “Në fund të verës” (1986) sjell poetikën e detit dhe lojën e simboleve. Në zhvillimin e poezisë vitet ‘90 “përplasin” brezat krijues. Poetët e fillimeve Mekuli, Gjerqeku etj. mbyllën poetikën e tyre pa ndryshuar ndjeshëm fahun

krijues, ndërsa poetët e viteve '70' si Basha, Hamiti etj., u panë si modele nga Ali Podrimja, Azem Shkreli etj. Poetët e viteve '80 si Çapriqi, Konushevcu etj. iu bashkëngjitën modeleve të tyre pararendese, por edhe hulumtuan forma alternative të vargut. Nga autorët e rinj të kësaj periudhe, të cilët sollën gërshetimin e traditës me hulumtime të reja, veçojmë: Halil Matoshin, Beqë Cufajn, Naime Beqirajn, Xhevdet Bajrajn, Fahredin Shehun, Xhavit Beqirin e Kujtim M. Shalën. Më 1999 ndodh jetësimi i lirisë, rikthimi i jetës artistike, por edhe shtimi i ndërndikimeve kulturore. Por, identitetin e poezisë së Kosovës e ruajnë dhe e kultivojnë autorët klasikë të katër brezave. Ndërkaq, si emra të rinj mbas këtij viti, mund të përmendën: Arben Idrizi, Vehbi Miftari, Blerina Rogova etj, të cilët vijojnë shkrimin e poezisë si formim të emrit të vet autorial. Poezia e Kosovës me traditën e saj tashmë mund të hyjë në procesin e përzgjedhjes së modeleve, duke shërbyer si ikonë për poetët e së ardhmes. (Nysret Krasniqi)

POGRAGJA. Fshat në komunën e Gjilanit në rajonin e Anamoravës, që shtrihet në shpatet veriperëndimore të maleve të Karadikut, në anën e djathtë të lumit Morava e Binçës, në lartësinë mbidetare 600 m. Është vendbanim i tipit të dendur. Në periferi të fshatit ndodhet Kalaja e Pogragjës. Në vitin 1948 popullsia e këtij fshati kishte 1,082 banorë, ndërsa në regjistrimin e fundit (2011) 1, 211 banorë dhe 231 ekonomi familjare. Popullsia merret kryesisht me blegtori, bujqësi dhe pylltari. Pogragja ka statusin e bashkësisë lokale në të cilën gravitojnë fshatrat Llovçë, Kokaj, Sllubicë, Bilinicë dhe Stublinë. Ka shkollën 9-vjeçare, stacionin shëndetësor, bibliotekën dhe disa njësi tregtare. (Nexhat H. Rexha)

POGRAGJA Hamdi (1921-1998). Veprimtar i çështjes kombëtare, i burgosur politik. Lindi në Pogragjë të Gjilanit. Më 1941 shpërngulet në Ferizaj, ku hapi një dyqan zejtar. Me vendosjen e pushtetit komunist në Ferizaj, u rreshtua në anën e atyre që nuk u pajtuan me gjendjen e krijuar. U përfshi në Lëvizjen Nacional-Demokratike Shqiptare. Mbajti kontakte edhe me Gjon Serreqin. Në tetor të vitit 1946 u zbulua nga OZN-a dhe u burgos me një grup prej 40 vetash. Më 1947 u dënua me 3 vjet. Pas daljes nga burgu, u vendos në Shkup. Në

gusht të vitit 1961 burgoset sërish dhe dënohet me 5 vjet heqje lirie. Më 1968 u angazhua në organizimin e demonstratave në Shkup dhe Tetovë, por pasi u zbulua nga organet e sigurimit emigroi në Austri. Më 1970 nga Vjena kaloi në Bruksel. Aty hapi restorantin "Iliria", i cili u bë qendër frekuentimi i veprimtarëve politikë të të djathtës shqiptare. Vdiq në Bruksel dhe u varros në Shkup. (Fehmi Rexhepi)

POLIKLINIKA HUMANITARE "NËNË TEREZA". Në fillim të viteve '90 Qeveria e Serbisë vendosi masa të dhunshme në mbi 90% të institucioneve shëndetësore të



POLIKLINIKA "NËNË TEREZA"

Kosovës. U përjashtuan nga puna mbi 2,500 punëtorë shëndetësorë shqiptarë, u mbyll Shkolla e Mesme e Mjekësisë dhe Fakulteti i Mjekësisë në Prishtinë. Për t'i ofruar ndihmë shëndetësore popullsisë, në mars të vitit 1992, në lagjen "Kodra e Trimave" në Prishtinë u hap ambulanca - poliklinika e parë humanitare "Nëna", me ç'rast u vunë themelet e shërbimit shëndetësor të Shoqatës Humanitare "Nënë Tereza". Që nga viti 1996 e deri në shtator të vitit 1999 në Prishtinë ka funksionuar edhe materniteti. Në mars të vitit 1999, në shkallë vendi funksiononin rreth 100 ambulanca të pavarura të kësaj shoqate. Nga viti 1992 e deri në 1999 në mbrojtje shëndetësore kontribuan 1,637 punonjës, prej të cilëve 443 mjekë të praktikës së përgjithshme, 208 specialistë, 884 infermierë dhe 102 punëtorë ndihmës. Ky shërbim ka kryer 2,784,914 vizita mjekësore, janë dhënë 1,554,999 injeksione, janë trajtuar 139,546 plagë, janë dhënë 11,886 infuzione etj. Në këtë poliklinikë vetëm brenda vitit 1997 lindën mbi 7,000 foshnje. Vizitat, konsultimet, intervenimet kirurgjikale, medikamentet dhe

shërbimet në ambulanca dhe lindjet në maternitet ishin tërësisht falas. Mesatarisht në ditë nëpër ambulancat e kësaj shoqate janë vizituar rreth 6,500 pacientë, përkatësisht 207,500 vizita në muaj. Në dy salla të lindjes dhe në një sallë të operacionit, gjatë kësaj periudhe, kanë lindur pa asnjë komplikim 12,385 foshnja. Pas shfaqjes së epidemisë së poliomielitit (paralizës së fëmijëve) në Shqipëri, u prek edhe pjesa kufitare e Kosovës, përkatësisht rajoni i Prizrenit me 25 raste. Ndërhyri Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) dhe UNICEF-i. Në bashkëpunim me Poliklinikën “Nëna”, u bë organizimi i ditëve nacionale të imunizimit me poliovaksinë. Përfaqësuesit e OBSH-së dhe të UNICEF-it bënë trysni te pushteti serb që këtë fushatë ta drejtojnë kuadrot e “Nënë Terezës” dhe të ish-Entit për Mbrojtje Shëndetësore të Kosovës. Në tri rrethe të vaksinimit u dhanë rreth 2 milionë doza të vaksinës kundër poliomielitit dhe epidemia e sëmundjes u frenua. Gjatë Luftës në Kosovë, nga forcat serbe u vranë 165 aktivistë të shoqatës, 57 veprimtarë u plagosën, 48 të tjerë janë të zhdukur, 38 u burgosën dhe 114 aktivistë u keqtrajtuat. (Gani Demolli)

POLIOMIELITI. Sëmundje akute ngjitëse, me natyrë virale, që prek trurin dhe brinjët e përparmë të palcës kurrizore. Paraqitet kryesisht të fëmijët. Karakterizohet me shfaqjen e paralizave të gjymtyrëve të poshtme, të cilat janë të pakthyeshme. Ndryshe quhet edhe sëmundja e “Hajne-Medinit”, (Heine-Medin, poliviral fever). Mund të manifestohet edhe me simptome jokarakteristike për sëmundjen, meningjitin aseptik si dhe paralizën flakcide të gjymtyrëve të poshtme. Në Kosovë nga vitit 1946 deri në 1996 janë raportuar 424 raste të sëmundjes me 21 të vdekur, me një letalitet prej 4.99%. Në vitin 1996, u paraqit epidemia e sëmundjes me 25 të sëmurë. Në Kosovë vakcina u aplikua pas vitit 1960, ndërsa, me program të rregullt, si vaksinë e obliguar me ligj u aplikua nga viti 1962. Prej vitit 1983-1990 në Kosovë nuk u regjistrua asnjë rast i sëmundjes. Por me rënien e përfshirjes së fëmijëve me vaksinim në periudhën 1991-1999 bëri që prej vitit 1990 deri në vitin 1996 të regjistrohen 56 raste të sëmundjes. Nga viti 1997 nuk është regjistruar ndonjë rast në Kosovë. Më 2002 Europa shpallet “e lirë nga polio”, ndërsa Kosova më 2004 shpallet (certifikohet) nga

Organizata Botërore e Shëndetësisë si “vend i lirë nga poliomieliiti”. Nga viti 2015 në Kosovë, sipas programit kombëtar për imunizim, ka filluar aplikimi i vaksinës polio inaktive (IPV). (Ariana Kalaveshi)

POLISI Faton (1986-). Gazetar i sportit. Lindi në Prishtinë. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Prishtinë. Pas përfundimit të studimeve dhe diplomimit në departamentin e gazetarisë në Fakultetin e Filologjisë, nisi punën si gazetar i sportit te e përditshmja “Epoka e re” në Prishtinë. Pjesë e gazetës “Epoka e re” ishte prej vitit 2009 deri më 2010. Prej atij viti është gazetar i sportit në të përditshmen “Koha ditore”, ku shkruan tekste për sportin vendor. (Arsim Maxhera)

POLISI Mehdi (1953-2014). Filolog orientalist dhe përkthyes. Lindi në fshatin Dobovjan të Strugës. Shkollimin e mesëm e mori në Medresenë “Alauddin” në Prishtinë, ndërsa studimet për



MEHDI POLISI

orientalistikë në Fakultetin Filozofik të Prishtinës. Punoi në Arkivin Historik në Ohër (1978-1980), ndërsa më pas në degën e orientalistikës në Prishtinë. Më 1988 kreu studimet pasuniversitare në Prishtinë dhe më 1997 mbrojti tezën e disertacionit të doktoratës. Ishte përgjegjës për Kosovën në projektin e shtetit të Kuvajtit “Enciklopedia e Kuvajtit për botën islame dhe pakicat myslimane”. Botoi studime, disa vepra autoriale dhe të përkthyer. Shquhet për kontributin e tij në përkthimin e veprave të Sami Frashërit nga gjuha osmane. Botoi një gramatikë të turqishtes dhe veprën studimore “Adaptimet fonetike dhe morfologjike të huazimeve orientale në gjuhën shqipe” (1987). Ishte pjesëmarrës aktiv me kumtesa në tubime shkencore, konferenca, tryeza, seminare, simpoziume etj., brenda dhe jashtë vendit. (Jahja Hundozi)

POLITIKA AGRARE. Mënyra të veçanta të ndërhyrjeve shtetërore në bujqësi, siç janë: politikat e çmimeve të prodhimit, politika e kreditimit, të subvencioneve, politika e tokave, të hulumtimeve shkencore etj. Politikat bujqësore lidhen me një mori masash

shtetërore, të cilat kanë ndikim në prodhimin e ushqimit, në shfrytëzimin e resurseve në bujqësi, në tregun vendor dhe të jashtëm, në konsumin e ushqimit dhe të ushqyerit, në sigurimin dhe sigurinë e ushqimit, për krijimin e kushteve të jetës në rajonet rurale etj. Pjesë e politikave bujqësore janë edhe politikat agroindustriale, pastaj politikat ushqimore dhe politika e zhvillimit rural. Politika agrare realizohet kryesisht përmes mekanizmave të ndërlikuar të eksportit dhe të importit, të kompensimeve (subvencioneve), të çmimeve, përmes politikave tatimore dhe kreditore. Politikat bujqësore në Kosovë kanë filluar të aplikohen me shumë vonesë, si rezultat i mungesës së mjeteve financiare dhe të organizimit institucional, pastaj të mungesës së vullnetit dhe të përgjegjësive përkatëse institucionale. Edhe sot instrumentet e politikave bujqësore janë të pamjaftueshme, jokonsistente dhe parçiale. Si objektiv afatgjatë i politikave bujqësore në Kosovë mbetet ngritja organizative menaxheriale e bartësve të biznesit dhe mbështetja institucionale e zhvillimit të agrobiznesit. (Halim Gjergjizi)

POLITIKA EKONOMIKE. Janë masat dhe veprimet që i ndërmerr një qeveri në fushën ekonomike, që përfshin llojin, strukturën dhe lartësinë e tatimeve dhe taksave, buxhetin, politikën monetare dhe normat e interesit, politikat e pronës, të punës, politikat tregtare etj. Dy janë fushat kryesore të kësaj ndërhyrjeje: politika fiskale, që përqendrohet në veprimet qeveritare rreth tatimeve dhe taksave; si dhe të shpenzimit të tyre në kuadër të buxhetit të shtetit dhe politika monetare, e cila merret me emetimin e parasë dhe rregullimin e normave të interesit. Në rastin e Kosovës, kur nuk ka një valutë nacionale dhe është në përdorim euroja, Banka Qendrore nuk e ka funksionin e emetimit të parasë, ndaj barra kryesore për rregullimin makroekonomik bie mbi politikën fiskale. Në përgjithësi Kosova ndjek politika ekonomike liberale, me taksat jo të larta, me normë të interesit të formuar lirisht në tregun e kredisë bankare dhe të tregtisë së lirë, pa kuota. Gjithashtu, deri më tani nuk ka pasur politika aktive industriale dhe politika aktive të tregut të punës. E gjithë kjo e ka reduktuar aktivitetin rregullues të qeverisë thua pa vetëm në politikën e tatimeve dhe taksave dhe ka ndikuar në zhvillimin e ngadalshëm të sektorëve të rinj prodhues. (Muhamet Mustafa)

POLITIKA FISKALE. Përdorimi i shpenzimeve qeveritare dhe i politikës së taksave për të arritur qëllime të caktuara ekonomike dhe sociale. Qëllimet ekonomike dhe sociale ndahen në tri kategori: alokative, shpërndarëse dhe stabilizuese. Qëllimet alokuese përfshijnë ndikimin e politikave buxhetore në alokimin e resurseve të një vendi, nëpërmjet të mirave publike, të rregullimit të eksternaliteteve dhe të resurseve të shoqërisë. Qëllimet shpërndarëse përfshijnë ndikimin e politikave buxhetore në shpërndarjen e të ardhurave të një shoqërie nëpërmjet ndikimit në grupe të ndryshme shoqërore. Qëllimet stabilizuese përfshijnë ndikimet e qeverisë në dukuritë e inflacionit, të papunësisë dhe të rritjes ekonomike. Në Republikën e Kosovës politikat fiskale përfshijnë instrumentin e buxhetit dhe të tatimit. Tatimet janë pesë llojesh: tatimi mbi vlerën e shtuar, tatimi mbi të ardhurat personale, tatimi mbi të ardhurat e korporatave, tatimi i paragjykuar dhe tatimi mbi fitimet. Përveç tatimeve, akcizat dhe tantimat përbëjnë forma shtesë të politikës fiskale. (Lumir Abdixhiku)

POLITIKA INDUSTRIALE. Janë tërësia e reformave dhe e masave ekonomike me qëllim të fuqizimit industrial të vendit. Këto politika ekonomike ishin shumë të përhapura në vitet '80. Ato i japin autoritet më të madh shtetit për të ndërhyrë në ekonomi përmes politikës fiskale dhe asaj monetare. Me këto politika synohet favorizimi i disa sektorëve industrialë, në të cilët shteti bazon zhvillimin ekonomik. Politika të njohura në këtë drejtim janë, bie fjala, mbrojtja e sektorëve të ndryshëm nga importi përmes tarifave dhe kuotave. Këto politika ekonomike kritikohen nga grupi i ekonomistëve neoliberalë, të cilët kundërshtojnë ndërhyrjen e tepërt të shtetit në ekonomi dhe favorizojnë tregun si rregullues të ekonomisë, ndërsa ekonomistë të tjerë i favorizojnë edhe funksionet zhvillimore të shtetit nëpërmjet politikave industriale, sidomos në vendet jo mjaft të zhvilluara. Politikat aktive industriale kanë qenë karakteristike në vitet '60-'80 për Kosovën, ndërsa në periudhën e pasluftës nuk ka pasur politika të tilla aktive. (Alban Zogaj)

POLITIKAT TREGTARE. Çdo politikë apo instrument që ndikon në tregtinë ndërkombëtare, në mënyrë specifike në tarifatat, në instrumentet jotarifore dhe marrëveshjet

për liberalizimin e tregtisë. Politika tregtare lidhet me segmente të caktuara të politikës fiskale, por edhe të asaj monetare. Ndërlidhja në mes të politikës tregtare dhe asaj fiskale është veçanërisht e ngushtë, meqë politika tregtare ndikon në politikën tatimore edhe atë buxhetore. Ndodh që qeveria synon t'i stimulojë disa sektorë të caktuar ekonomikë dhe këtë e bën përmes tarifave doganore, në njërën anë, dhe duke ngritur kapacitetet e këtyre sektorëve, në anën tjetër. Në kontekst të politikës tregtare, Kosova ka marrë një drejtim gati tërësisht liberal dhe, për rrjedhojë, aplikon masa shumë të kufizuara në tregtinë e jashtme. Me nënshkrimin e Marrëveshjes së CEFTA-s në vitin 2006, Kosova ka liberalizuar në tërësi tregtinë me vendet fqinje. Në të njëjtën kohë Kosova është në proces të liberalizimit të tregtisë me vendet e BE-së (në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit) dhe me Turqinë. Më këta partnerë tregtarë marrëveshjet janë favorizuese për Kosovën, pasi liberalizimi i një numri të produkteve nga ana e Kosovës do të bëhet për një periudhë deri në 10 vjet dhe tarifatat doganore të aplikuar janë dy nivelesh, pra 0 dhe 10 për qind. Masat jotarifore janë gati të paqena. Këtë qasje Kosova e ka ofruar përmes dy politikave të aprovuara tregtare pas vitit 1999: e para e vitit 2005, ndërsa e dyta e vitit 2009. Të dyja këto politika e theksojnë rëndësinë e tregtisë së jashtme dhe propozojnë një qasje të koordinuar në ngritjen e aftësisë konkurruese të sektorëve vendorë. (Petrit Gashi)

POLLATA. Fshat në komunën e Podujevës. Shtrihet në grykëderdhjen e përroit të Mavriqit në lumin Llap. Sipërfaqja e territorit të fshatit është 671 ha. Popullsia merret kryesisht me bujqësi dhe blegtori. Në truallin e këtij vendbanimi gjenden gjurmë materiale të lashtësisë. Në dokumentet e shkruara përmendet në defterin kadastral Vëllk të vitit 1455 me 8 shtëpi. Pollata ka funksionin e bashkësisë lokale për fshatrat: Dvorishtë, Sllatinë, Reçicë, Potok, Zhiti, Brecë, Murgull, Tërrenavicë dhe Sylevicë. Nga objektet e standardit shoqëror ka shkollën fillore, zyrën e vendit, njësi tregtare etj. (Skender Halimi)

POLLOSHKA Avdullah-Dah (-1845). Luftëtar i kryengritjeve antiosmane. Lindi në Gjakovë. Sa herë që kërcënohej nga pushteti osman, dilte kaçak në Geghysenaj. Në kohën e

fushatës për zbatimin e reformave të Tanzimatit në Shqipëri, kryekomandanti i Rumelisë, mareshali Mehmet Reshit Pasha, autori i masakrës së Manastirit, pasi shtypi lëvizjen kryengritëse kundër Tanzimatit në viset e tjera të Kosovës (1844-1845) u drejtua kundër forcave kryengritëse të kazasë së Gjakovës, të Rekës, të Gashit, të Krasniqes e të Byryçit. Kryengritësit në ballë me Binak Alinë, Sokol Ramën, Sylejman Vokshin, Haxhi Zekën, Dah Polloshkën etj., dëbuan garnizonin osman nga Gjakova. Por trupat osmane shtinë në dorë disa vise kryengritëse (qershor 1845). Për të shpëtuar nga terrori i ushtrisë osmane, D. Polloshka vendosi ta vriste mareshalin osman, i cili e kishte vendosur kampin e ushtrisë së tij në Nakaradë, në jug të Gjakovës. Me këtë qëllim u fut në kampin ushtarak dhe kërkoi të hynte te komandanti osman, por komandanti i truporës nuk e lejoj. Ai vrau dy roje, por edhe u plagos. Në ikje e sipër me kalin e tij, vrau edhe ushtarë të tjerë, derisa i plagosur rëndë ra në duart e tyre. E ekzekutuan, duke e prerë për së gjalli, me urdhër të Mehmet Reshit Pashës. (Masar Rizvanolli)

POLLOZHANI Azis (1957-). Mjek, kirurg, profesor universiteti. Lindi në Strugë. Mbaroi shkollimin fillor në Ohër, kurse gjimnazin në Strugë. Kreu studimet në Fakultetin e Mjekë-




AZIS POLLOZHANI

sisë në Prishtinë (1981). Pas diplomimit dy vjet punoi në Drenas dhe nga viti 1983 në Klinikën e Kirurgjisë në Prishtinë, në shërbimin e kirurgjisë vaskulare. Kreu specializimin për kirurgji të përgjithshme në Zagreb, kurse specializimin për kirurgji plastike rekonstruktive në Cyrih, Zvicër (1992). Hapi poliklinikën e parë private në Strugë, Maqedoni. Ndërkohë u inkuadrua në jetën politike të Maqedonisë, duke u zgjedhur deputet i Parlamentit të Maqedonisë në tri legjislatura, kurse në periudhën 2002-2006 ushtroi detyrën e ministrit të Arsimit dhe të Shkencës. Në vitet 2008-2009 ishte drejtor i Institutit të Shëndetit Publik të Republikës së Maqedonisë, kurse gjatë viteve 2009-2012 ishte ambasador i Maqedonisë në OKB, Gjenevë. Është mësimdhënës në Universitetin Shtetëror të Tetovës dhe në Universitetin e

Europës Juglindore po në Tetovë. Ka botuar disa punimeve shkencore në revista të ndryshme ndërkombëtare nga fusha e shëndetësisë dhe është autor dhe bashkautor i teksteve universitare: “Aspekte moderne të menaxhimit shëndetësor” (2008), “Ekologjia humane dhe shëndeti publik” (2009), “Ekologjia humane me higjienë” (2013). Nga viti 2012 është redaktor përgjegjës i revistës së shkencave mjekësore, “Medicus”, që botohet në Shkup. (Avdyl Krasniqi)

POLLUZHA Shaban (1871-1945). Komandant i Brigadës së Drenicës dhe udhëheqës i Luftës së Drenicës në janar të vitit 1945. Hero i Kosovës. Lindi në fshatin Polluzhë. Gjatë Luftës



SHABAN POLLUZHA


së Parë Botërore luftoi kundër pushtimit bullgar. Në kohën e Mbretërisë Serbe-Kroate-Slllovene u zgjodh kryetar i komunës së Verbofcit. U shqua si pajtues i gjaqeve dhe përkrahës i lëvizjes kaçake. Gjatë Luftës së Dytë Botërore mori pjesë në

luftërat kundër sulmeve çetnike në Sanxhak dhe Kosovë. Në vitin 1943 Këshilli i Naltë i Qeverisë së Përkohshme e emëroi kryetar i komunës së Skënderajt. Më 20 nëntor 1944 organizoi Kuvendin e Drenicës me 200 pjesëmarrës, i cili vendosi për mobilizimin e të rinjve në radhët partizane, mbështetur në Rezolutën e Bujanit. Për ndihmën që i dha lëvizjes antifashiste u arrestua dhe u burgos bashkë me familjen në Pejë. Në rrethanat që u krijuan, më nismën e disa krerëve të Drenicës, në mesin e tyre edhe kundërshtarë të rreptë të komunistëve, u mbajt Kuvendi i Polluzhës, ku u krijua Shtabi i Përgjithshmi të Lëvizjes për Çlirim dhe Bashkim Kombëtar, në krye të të cilit u zgjodh Shaban Polluzha. Pas formimit të Brigadës VII të Kosovës, formacionet e komanduara nga Sh. Polluzha u rreshtuan në këtë njësit dhe ai u caktua zëvendëskomandant. Në janar të vitit 1945, pas dy takimeve me Fadil Hoxhën në Mitrovicë dhe Skënderaj, pranoi që brigada që e komandonte ai të nisej për Frontin e Sremit, në veri të Jugosllavisë. Por për shkak të gjendjes së rëndë në Kosovë, pas hyrjes së forcave partizane, tërhiqet nga ky vendim dhe vazhdoi luftën vetëmbrojtëse kundër vendosjes së pushtetit komunist. Pas luftimeve të përgjakshme, më 21 shkurt 1945 u vra nga forcat partizane serbo-malazeze. (Izber Hoti)

POMAK Pajazit (1924-1987). Ekonomist, profesor universiteti. Lindi në Brod, komuna e Dragashit. Shkollimin e kreu në vendlindje, në Prishtinë, në Beograd dhe në Shkup. Një kohë punoi si profesor dhe drejtor i shkollës së mesme të partisë të Komitetit Krahinor të Lidhjes së Komunistëve të Kosovës në Prishtinë. Studimet pasuniversitare i kreu në Beograd (1968), ndërsa doktoroi në Universitetin e Shkupit (1975). Në vitin 1976 u zgjodh profesor ordinar në Fakultetin Ekonomik të Prishtinës. Krahas punës shkencore dhe pedagogjike ishte punëtor aktiv politiko-shoqëror. Botoi disa punime shkencore dhe profesionale, tekste, monografi etj. (“Çmimi normal në teorinë marksiste ekonomike”, “Ekonomia politike e kapitalizmit” etj.). Ishte bashkautor i tekstit “Ekonomia politike e socializmit”, e cila së pari u botua në gjuhën serbokroate (1983), pastaj edhe në gjuhën shqipe (1984). (Selman Selmanaj)

PONOSHECI. Fshat në Rekën e Keqe në perëndim të Gjakovës, rreth 20 km larg nga qendra. Është vendbanim i tipit të grumbulluar, i vendosur në anën e djathtë të lumit Erenik, në lartësi mbidetare 420-523 m. Ndodhet vetëm 7 km larg kufirit me Republikën e Shqipërisë. Ponosheci ka qenë qendër e Rekës së Keqe gjatë gjithë shekullit XX. Është pikë e rëndësishme komunikuese ndërmjet Gjakovës, Bajram Currit dhe Junikut. Popullsia merret kryesisht me bujqësi (kultivimi i misrit dhe groshës), pemëtari (mollë, kumbull, arrë), blegtori (gjedhe dhe dele) dhe bletari. Një numër i banorëve punon dhe jeton jashtë Kosovës. Në vitin 2011 Ponosheci kishte 585 banorë, ndaj 457 banorëve në vitin 1921. Është qendër lokale e disa vendbanimeve përreth: Brovinë, Stubëll, Smolicë, Popoc, Shishman dhe Morinë. Ka shkollë 9-vjeçare, shkollën e mesme, qendër shëndetësore, disa objekte tregtare etj. (Qerim Kastrati)

PONOSHECI Ibrahim. (1947-2008). Pikturor. Lindi në Gjakovë. Kreu shkollimin fillor dhe të mesëm në Gjakovë, studimet për pikturë në Akademinë e Arteve Figurative në Beograd (1974). Shquhet si pikturor i abstrakcionit ekspresiv, ku figura dhe portreti abstrakt paraqiten me kolorit intensiv. Ishte anëtar aktiv i Shoqatës së Artistëve Figurativë të Kosovës (SHAFK), përmes së cilës realizoi një sërë



IBRAHIM
PONOSHECI

prezantimesh. Realizoi disa ekspozita personale, si në Prishtinë (1975), Gjakovë (1976, 1987, 2004), Ulqin (2004) dhe mori pjesë në një sërë ekspozitash të përbashkëta në Prishtinë, Këln, Hamburg, Paris, Lion, Dubrovnik, Tuzëll, Nju-Jork, Kairo, pastaj në Sallonin Pranveror, në ekspozitën me rastin e 40-vjetorit të shoqatave të artistëve jugosllavë në Tuzëll, në ekspozitën jubilarë të Galerisë së Arteve në Prishtinë, si dhe në Sallonin e Nëntorit dhe Sallonin Vjeshtore dhe Pranverore të SHAFK-ut. Fitoi disa çmime dhe mirënjohje: më 1972 për vizatim në Beograd, çmimin “100-vjetori i Lidhjes së Prizrenit” në Prizren më 1978, pastaj çmimin për Lapidarin e Dëshmorëve në Gjakovë etj. Nga viti 1974 që mësimdhënës i lëndës vizatim në Fakultetin e Arteve në Prishtinë. (Hajrush Fazliu)

POPOCI Ibrahim Halit (?-1905). Atentatori i konsullit rus në Mitrovicë, Grigor Shçerbinit. Lindi në fshatin Sukë të rrethit të Gjilanit. Ishte mobilizuar në Shkup dhe u gjend në Mitrovicë si tetar i ushtrisë osmane për të luftuar kundër shqiptarëve të armatosur, të cilët sulmuan Mitrovicën, të mllefosur nga pëlqimi i Portës së Lartë, që Rusia të hapte konsullatën në këtë qytet. Në shtator të vitit 1902, nga Rusia u dërgua konsull në Mitrovicë, Grigor Shçerbini. Shqiptarët e vilajetit të Kosovës organizuan një varg protestash, kurse ngjarjet rreth Mitrovicës u ashpërsuan, kur më 30 mars 1903, 2,000-3,000 shqiptarë të armatosur sulmuan Mitrovicën, për ta përzënë prej andej konsullin rus. Në këtë rrethanë, Porta e Lartë urdhëroi garnizonin e Mitrovicës dhe forcat e artilerisë të sulmonin kryengritësit. Në mbrëmje, kur kryengritësit iu afruan qytetit, konsulli rus Shçerbin, duke qarkulluar në llogoret e ushtrisë dhe artilerisë osmane, i nxiste ata të sulmonin sa më ashpër shqiptarët. Me këtë rast mbi 200 shqiptarë mbetën të vrarë në hyrje të qytetit. Të nesërmen, më 1 prill 1903, konsulli Shçerbin u qëllua për vdekje gjatë një inspektimi ushtarak nga I. Popoci. Kjo vrasje pati jehonë të madhe në qarqet diplomatike europiane. I. Popoci u dënua me burg të përjetshëm, por pas dy vitesh vdiq nga torturat në burgun e Shkupit. (Aliriza Selmani)

POPOVA Hysë (1856-1924). Luftëtar dhe prijës i anës së Llapit në luftë kundër pushtuesve osmanë dhe serbë. Lindi në Popovë të Llapit. Familja Popova ishte e njohur. Nga kjo familje ishte edhe Tahir Efendija, përkthyes i Mevludit në gjuhën shqipe. H. Popova u dallua në kryengritjet kundër Perandorisë Osmane në fillim të shekullit XX dhe më 1912 ishte komandant rajonal i kryengritësve në luftë kundër ushtrisë osmane. Gjithashtu më 1912 u priu vullnetarëve në luftë kundër ushtrisë serbe në betejat e Merdarit dhe të Llpashticës. Gjatë Luftës së Parë Botërore luftoi kundër Bullgarisë. Bashkëpunoi me Hasan Prishtinën dhe Komitetin Mbrojtja Kombëtare e Kosovës, duke organizuar rezistencën kundër Serbisë. Ishte njëri ndër bashkëluftëtarët e Azem Bejtës dhe bashkëpunoi me krerët e lëvizjes kaçake edhe në viset e tjera të Kosovës. U vra më 1924 në një betejë ku u plagos edhe Azem Bejta. (Fehmi Pushkollli).

POPOVA Shefki (1950-2000). Gazetar. Lindi në Vushtrri. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, kurse u diplomua në Universitetin e Prishtinës. Profesionin e gazetarit nisi ta ushtrojë në gazetën “Rilindja”, ku punoi 26 vjet si korrespondent nga Vushtrria dhe gazetar i sportit. Bashkëpunoi edhe me revista të ndryshme që u botuan në Kosovë. Gjatë periudhës së luftës në Kosovë (1998-99), pos raportimeve nga zonat e luftës, ishte aktiv në organizatat humanitare që grumbullonin ndihma për popullsinë civile dhe luftëtarët e UÇK-së. U vra në Vushtrri më 10 shtator 2000. (Nehat Islami)

POPOVA Tahir efendi (-1949). Titullar i fesë islame, mësues, vjershëtor. Lindi në fshatin Popovë, komuna e Vushtrrisë. Pas mbarimit të arsimit fillor shkoi në Stamboll, ku studioi në Medresenë “Shehzade” dhe në Shkollën e Lartë Pedagogjike “Sulltanije”. Pas studimeve, një kohë punoi si hoxhë dhe mësues i fesë në Vushtrri dhe në Mitrovicë. Më 1890 u emërua mësues në gjimnazin e ulët “Ruzhdije” të Novi-Pazarit, ku qëndroi deri në vitin 1908. Më pas u transferua në Berane dhe sërish në Novi-Pazar si mësues feje i shkollës fillore dhe i gjimnazit. Në vitin 1934 vendosi të shkojë te djali i tij në Tiranë, ku edhe e kaloi pjesën tjetër të jetës. Është autor i veprës “Përmbledhje në vargje mbi qenien më të vlefshme në gjuhën shqipe”, të cilën e shkroi

sa ishte student i shkollës së lartë “Sulltanije” në Stamboll. Mevludi i Tahir efendi Popovës pati shtrirje të gjerë. Edhe sot këndohet në manifestime fetare në Kosovë. (Ramadan Shkodra)

POPOVIQ Ivan (Popović) (1923-1961). Gjuhëtar, profesor serb. U mor me historinë e gjuhës serbe dhe me studimin e dialekteve të saj, por rëndësi i ka kushtuar edhe gjuhës shqipe, etimologjisë dhe origjinës së saj. Pjesa e parë e veprës së tij “Histori e gjuhës serbokroate” (Geschichte der serbokroatischen Sprache, 1961) mbahet si një traktat i veçantë i ballkanistikës. Mbrojtiti tezën e Henrik Bariqit për origjinën trakase të gjuhës shqipe. Botoi artikuj në revistat “Jeta e re” dhe “Përparimi” (1953-1957), kryesisht për raportet e shqipes me gjuhët e tjera. Është marrë posaçërisht me ndikimet e shqipes në gjuhët sllave të jugut. Ishte profesor në Universitetin e Novi Sadit dhe në Berlin. (Naile Mala-Imami)

POPOVIQ (Popović) Miladin (1910-1945). Funkionar i lartë komunist jugosllav, sekretar i Komitetit Krahinor të Partisë Komuniste të Jugosllavisë (PKJ) për Kosovë, pjesëmarrës i mbledhjes themeluese të Partisë Komuniste të Shqipërisë si delegat i PKJ-së, Hero i Popullit. Lindi në fshatin Lijeva Rijeka, në afërsi të Podgoricës në Mal të Zi. Kur ishte i ri familja e tij qe vendosur si kolonistë në Pejë. Gjimnazin e ndoqi në Pejë, në Prizren dhe në Prishtinë, ndërkaq Fakultetin e Drejtësisë e kreu në Beograd. Më 1933 u anëtarësua në Bashkimin e Rinisë Komuniste të Jugosllavisë, ndërkaq në vitin 1934 u bë anëtar i PKJ-së. Në vitin 1936 organizoi demonstrata kundër qeverisë së Milan Stojanoviqit në Pejë. Më 1939 u zgjodh sekretar politik i PKJ-së për Kosovë, ndërkaq në maj të vitit 1941 sërish organizoi demonstrata, këtë radhë kundër administrimit italian në Pejë. Në po këtë vit u arrestua nga italianët në Mal të Zi dhe u internua në Peqin (Shqipëri). Nga aty u lirua nga komunistët e Shqipërisë. Përgjatë pjesës së mbetur të luftës qëndroi në Shqipëri, ku së bashku me Dushan Mugoshën bashkëpunoi me komunistët shqiptarë për themelimin e Partisë Komuniste të Shqipërisë, si i deleguar i Komitetit Qendror të PKJ-së. Në shtator të vitit 1944 u zhvendos në Kosovë, si sekretar politik i Komitetit Krahinor të PKJ-së për Kosovë. U vra në një atentat në zyrën e tij në Prishtinë. (Mrika Limani)

POPOVIQ Luba (Ljuba Popović) (1934-). Poet i letërsisë serbe nga Kosova. Lindi në Igrësh, afër Brusit në Serbi. Fëmijërinë e kaloi në afërsi të Podujevës. Gjimnazin dhe studimet për gjuhë serbokroate dhe letërsinë jugosllave i mbaroi në Prishtinë. Ishte mësimdhënës në gjimnazin e Podujevës dhe më pas punoi në administratën komunale po në Podujevë. Botoi një sërë librash me poezi: “I përndjekuri i lumtur” (1966), “Kryengritja e pamposhtur” (1968), “Kështjella dhe rrathët” (1970), “Radhori” (1974), “Vapa e humnerës” (1976), “Shiu i mesditës” (1979) etj. Libri me poezi të zgjedhura “Malli për të papërjetuarën” u përkthye dhe u botua edhe në gjuhën shqipe. (Ismet Marković)

POPULLSIA URBANE DHE RURALE. Sipas regjistrimit të popullsisë, ekonomive shtëpiake dhe të banesave të vitit 2011, popullsia e Kosovës është e shpërndarë në 1,467 vendbanime. Rreth 26% e popullsisë është e përqendruar në 7 qendra kryesore urbane, të cilat janë gjithashtu edhe qendra rajonale. Popullsia urbane është 38.3% në nivel vendi, kurse 61.7% e popullsisë jeton në zonat rurale. Të dhënat për migrimin e brendshëm që janë mbledhur gjatë regjistrimit të popullsisë të vitit 2011 tregojnë se lëvizjet e popullsisë brenda Kosovës janë ndikuar nga arsye të punësimit, arsimit dhe ato familjare. Ndryshimet më të rëndësishme janë duke u zhvilluar në komunën e Prishtinës. Derisa të dhënat tregojnë se ka pasur rritje të numrit të popullsisë në kryeqytet dhe në disa komuna fqinje, si Fushë-Kosovë dhe Graçanicë, komuna të tjera, si Kamenica dhe Podujeva janë duke humbur numër të madh të banorëve. Në nivel vendi, ekonomitë familjare janë 297,090, nga të cilat 43% janë në viset urbane (128,131). Rreth 74% e tyre posedojnë kompjuterë, kurse qasje në internet kanë afër 70% e ekonomive familjare urbane. Popullsia rurale e Kosovës ka pësuar transformime të konsiderueshme në pikëpamje sociale-profesionale, demografike, arsimore, infrastrukture, në mënyrën e jetesës dhe në vetëdijen e njerëzve etj. Kjo dëshmohej më së miri edhe me faktin se rreth 54% e ekonomive familjare rurale posedojnë kompjuterë, kurse qasje në internet kanë 47.4%. Një fakt shqetësues mbetet se ende 3.6% e ekonomive familjare rurale nuk kanë qasje në ujë nga ujësjellësi si dhe mbi 45% e banesave nuk kanë qasje në ndonjë shërbim

të kanalizimit. Numri mesatar i anëtarëve të ekonomive familjare është 5.9 persona në nivel vendi, në zonat urbane është 5.2 dhe 6.4 në zonat rurale.

Derisa në vitin 1948 numri i popullsisë urbane ishte rreth 71,000 (9.7%), në vitin 2011 ai rritet në rreth 682,000 banorë. Në periudhën 1953-1981 popullsia urbane rritet për 388,300 banorë ose për 306.9%, ndërsa në periudhën 1953-2011 përreth 555,000 banorë ose 440%. Burim themelor i rritjes demografike të qyteteve të Kosovës është rrjedha demografike, pra numri i popullsisë dhe shtimi i vazhdueshëm i tij nga komponenti natyror (shtimi natyror) dhe më shumë nga ai mekanik (imigrimi). (Rahmije Mustafa-Topxhiu)

POPULLSIA. Popullsinë e përbëjnë të gjithë banorët rezidentë të një vendi. Sipas regjistrimit të vitit 2011, Kosova ka 1,780,021 banorë rezidentë. Popullsia e Kosovës është mjaft e re: 28% e saj është më e re se 15 vjeç, gjysma e popullsisë është më e re se 28.2 vjeç, moshja mesatare e popullsisë është 30.2 vjet. Jetëgjatësia mesatare në Kosovë për të dy gjinitë për vitin 2011 është vlerësuar të jetë 76.7 vjet. Dominon popullsia e aftë për punë, me rreth 65.3%, vetëm 6.7% e popullsisë janë më të vjetër se 65 vjet. Pjesa dërrmuese e popullsisë janë shqiptarë, rreth 93% e tyre.

Shënimet e para për numrin e popullsisë në Kosovë datojnë që nga viti 1880, kur në Kosovë jetonin 240,000 banorë. Para luftërave ballkanike, përkatësisht në vitin 1910 konsiderohet se në Kosovë kanë jetuar 475,000 banorë, kështu që për 30 vjet popullsia e Kosovës u rrit për 235,000 banorë të rinj ose për 98%, duke shënuar rritje me normë vjetore prej 2,3%, që për atë kohë ishte rritje mjaft e lartë. Kjo rritje e popullsisë së Kosovës është shënuar edhe nga ardhja e muhaxhirëve shqiptarë nga Sanxhaku i Nishit të dëbuar nga Serbia pas vitit 1878. Në vitin 1921, kur u bë regjistrimi i parë i popullsisë i Mbretërisë Jugosllave, në Kosovë u konstatua numër më i vogël i popullsisë, rreth 439,000 banorë. Në këtë periudhë, 1910-1920, popullsia e Kosovës zvogëlohet për 36,000 banorë, si pasojë e dy luftërave ballkanike dhe Luftës së Parë Botërore, si dhe të shpërnguljes për në Turqi. Edhe mortaliteti i popullsisë ka qenë shumë i madh, 30-40% mesatarisht në vit, kështu që shtimi natyror ka qenë shumë i ulët rreth 2 dhe 5%, edhe pse natalitetit ishte i

lartë. Për 20 vjet të tjera, nga viti 1921 e deri në vitin 1941, popullsia e Kosovës u shtua për 210 mijë banorë ose për 47.8% me normë vjetore 2% ose 20%. Kjo rritje është e kuptueshme, sepse në këtë periudhë nuk ka pasur lufta dhe, në anën tjetër, shtimi natyror është rritur në rreth 15%, ndërsa mortaliteti është zvogëluar rreth 10%. Edhe këtë periudhë e karakterizon valë e madhe e imigrimit dhe emigrimit, por është e vështirë të vlerësohet numri i popullsisë serbe të ardhur dhe popullsisë shqiptare të shpërngulur. Në periudhën prej viti 1940 deri në vitin 1948, kur është bërë regjistrimi i parë i popullsisë në Jugosllavinë socialiste, numri i popullsisë së Kosovës është rritur prej 671,000 në 733,000 banorë, që do të thotë përreth 62,000 banorë. Nuk ka dyshim që kjo rritje e vogël është pasojë e humbjeve të drejtpërdrejta në Luftën e Dytë Botërore. Pas kësaj fillon periudha e kompensimit të popullsisë së humbur: rritet nataliteti dhe shtimi natyror i popullsisë. Për periudhën 1948-1971, popullsia e Kosovës rritet gjithsej për 510,659 banorë ose për 70.1%, mesatarisht për 22,492 banorë në vit. Është karakteristike periudha 1961-1971, ku popullsia rritet për 280,000 banorë (indeksi 129.2), që edhe në përmasa europiane dhe botërore bën përjashtim. Me regjistrimin e vitit 1981, Kosova kishte 1,584,000 banorë, dhe, krahasuar me 10 vitet e mëhershme, popullsia u shtua për 340,000 banorë (27.33%).

Në vitet '90 emigroi 18-20% e popullsisë së Kosovës në vendet e Europës dhe vende të tjera, duke u larguar nga Kosova mbi 350 mijë banorë, kryesisht të rinj. Si rezultat i këtyre shpërnguljeve dhe luftës së zhvilluar në Kosovë në vitin 1998-1999, në periudhën 1981-2011, popullsia e Kosovës u shtua për 196 mijë banorë, ose me vetëm 12.4%, me normën vjetore 0,41%. Nga viti 1921 deri në vitin 2011 (periudhë 90-vjeçare), popullsia e Kosovës është rritur për 1,341,011 banorë.

Deri në regjistrimin e fundit të vitit 2011, rezultatet janë prezantuar në bazë të koncepcionit të popullsisë rezidente dhe jorezidente, ndërsa në regjistrimin e popullsisë të vitit 2011 nuk është përfshirë popullsia që jetonte jashtë Kosovës për më shumë se 12 muaj. Andaj për shkak të ndërrimit të metodologjisë, lindin vështirësi për krahasimin e popullsisë me vitet e mëparshme (Rahmije Mustafa-Topxhiu)

PORFYROGJENETI Konstandin VII (Constantine VII Porphyrogenetus) (905-959).

Perandor bizantin, shkrimtar. Lindi në Konstandinopojë. Ishte djali i vetëm i perandorit bizantin Leoni VI Dijetari (886-912), i cili në vitin 911 e kurorëzoi bashkëperandor. Pas vdekjes së Leonit VI dhe më pas të xhaxhait të tij, Aleksandrit, për shkak se ishte i mitur, qeverisjen e shtetit e mori në dorë këshilli i regjencës. Konstandin VII e mori në dorë drejtimin e shtetit më 945, por nuk tregoi interes për punët shtetërore. Ai iu përkushtua zhvillimi të kulturës dhe të shkencës, prandaj mbledhi rreth vetes shumë dijetarë, të cilët shkruan një varg veprash historike dhe redaktuan ekstrakte të shkrimtarëve dhe historianëve të vjetër.

Konstandin VII është autor i veprës “Mbi Themat” (*De thematibus*), në të cilën trajtoi ndarjen administrative të Perandorisë Bizantine në shek. X, por në të ka të dhëna edhe nga shekujt e mëhershëm. Aty jepen të dhëna edhe për shtrirjen territoriale të themave të Nikopojës dhe të Durrësit, si dhe përmendet provinca e Dardanisë me 3 qytete. Perandori, veprën tjetër “Mbi drejtimin e Perandorisë” (*De administrando imperio*) ia kushtoi të birit dhe trashëgimtarit të tij, Romanit II (959-963), me qëllim që ta njoftonte për problemet që e prisnin si sundimtar. Në të jepen të dhëna për strategjinë politike të Perandorisë Bizantine ndaj popujve fqinj për atdheun e lashtë të sllavëve dhe shpërnguljen e tyre në Ballkan, si dhe për gjendjen në trojet arbërore, si: shtrirja e popullsisë sllave në tokat arbërore, kërkesa e dukës së Durrësit për të bërë marrëveshje me princin e Rashës kundër bullgarëve (917) etj. Veprat e tij mbeten burime të rëndësishme historike. (Qerim Dalipi)

POSTA DHE TELEKOMUNIKACIONI I KOSOVËS (PTK). Ndërmarrje publike, e transformuar në shoqëri aksionare, e cila ofron një gamë të gjerë të shërbimeve dhe produkteve të telefonisë mobile, të telefonisë fikse, të internetit dhe të televizionit kabllor, me qëllim të përmbushjes së nevojave dhe kërkesave të konsumatorëve. PTK-ja e ka shtrirë rrjetin në tërë territorin e Kosovës. Me këtë operator konsumatorët marrin shërbimet më të avancuara të telefonisë dhe të internetit mobil dhe fiks brenda dhe jashtë operatorit të PTK-së, me teknologjitë e reja 3G dhe 4G. Vala/PTK mban pozitën e liderit



POSTA DHE TELEKOMI I KOSOVËS

të shërbimeve të telekomunikimit në vend, duke ofruar shërbime dhe produkte për një numër shumë të madh të konsumatorëve. Mban edhe primatin në tregun e telefonisë fikse, pasi e ka shndërruar rrjetin e vet analog në atë të gjeneratës së ardhshme (NGN), duke mundësuar ofrimin e shërbimeve të telefonisë, internetit dhe televizionit përmes protokollit të internetit (IPTV). PTK-ja është në hap me trendet botërore të zhvillimit, duke siguruar mbulim cilësor përmes rrjetit mobil dhe atij fiks në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Ka marrëveshje roaming me një numër të madh të operatorëve botërorë në vende të ndryshme të botës.

Shërbimet e Postës dhe të Telekomunikimeve kanë qenë të njohura për qytetarët e Kosovës që nga viti 1959, kur më 21 dhjetor të atij viti u themelua Posta, Telefoni dhe Telegrafi i Kosovës (PTT). Ndryshimi i emrit nga PTT në PTK apo Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës u bë në vitin 1999, pas rikonsolidimit të kompanisë së shërbimeve postare dhe telefonike të UNMIK-ut. Pas ndarjes së njësisë së Postës nga kompania amë, Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës (PTK) në gusht të vitit 2012, mbeti ende me emrin e saj të vjetër, megjithëse Posta u nda në një organizatë më vete. Tani PTK-ja numëron 2,305 punonjës, ndërsa Qeveria e Republikës së Kosovës është pronare e 100% të aksioneve. (Rahmije Mustafa-Topçiu)

POZHARANI. Fshat në komunën e Vitisë, 7 km në veri të qendrës së qytezës, pranë rrugës Gjilan-Ferizaj. Është vendbanim fushor i tipit të grumbulluar, me sipërfaqe prej 974 ha dhe lartësi mbidetare 500 m. Pjesën më të madhe e zënë arat me 87% dhe pjesa tjetër është zonë e ndërtuar me 13%. Përmendet në

defterët kadastralë të kazasë së Novobërdës në shekullin XV po me këtë emër, ndërsa në një hartë austriake të vitit 1689 ishte regjistruar si vendbanim me emrin “Posarane”. Nga viti 1913 këtu filluan të vendosen kolonët serbë, ndërsa shqiptarët dëboheshin për në Turqi. Popullsia merret me kultivimin e drithërave dhe perimeve. Në vitin 2011 kishte 4,247 banorë, ndaj 1,049 banorëve në vitin 1921. Ka shkollën 9-vjeçare, qendrën e mjekësisë familjare, disa njësi tregtare etj. (Përparim Gashi)

POZHARI Demë Ali (1905-1974). Veprimtar i lëvizjes çlirimtare. Lindi në fshatin Pozhar të Deçanit. Ishte njëri ndër organizatorët e luftës për mbrojtjen e Plavës dhe të Gucisë, të Tutinit, Novi Pazarit, Rugovës dhe të Rrafshit të Dukagjini (1941-1945). Ishte nënprefekt i Rozhajës dhe pjesëtar i Lidhjes së Dytë të Prizrenit. Drejtoi njësitë vullnetare të rajonit të Dukagjinit kundër forcave partizane më 1945. Edhe pse organet e pushtetit ia dogjën tri herë shtëpinë, ia arrestuan dhe ia dënuan 50 anëtarë të familjes dhe të rrethit familjar, nuk e ndërpreu qëndresën e armatosur kundër forcave jugosllave të ndjekjes deri në vitin 1949 kur u detyrua të emigrojë në Turqi. Edhe atje e vazhdoi veprimtarinë patriotike. Ishte pjesëmarrës në mbledhje e tubime të ndryshme dhe punoi për ndërkombatrimin e çështjes së Kosovës. Si përfaqësues i shqiptarëve të Turqisë, në vitin 1968 mori pjesë në kremtimin e 500 vjetorit të vdekjes së Skënderbeut në Tiranë. Vdiq në Stamboll (Haki Kasumi)

POZHEGU Mensur (1944-). Gazetar. Lindi në Gjakovë. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, ndërsa studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe i ndoqi në Fakultetin Filozofik të Prishtinës. Me gazetari aktive filloi të merret që nga viti 1967, si gazetar i së përditshmes “Rilindja”. Në fillim ndoqi zhvillimet në sektorin e arsimit fillor dhe të mesëm të Kosovës e më pas veprimtarinë arsimore në Universitetin e Prishtinës. Një kohë ishte edhe redaktor i rubrikës së humorit dhe satirës “Anza e Rilindjes” dhe “Në pauzë”. Në “Rilindje” punoi edhe si ndihmësredaktor i rubrikës së kulturës, ndërsa pas vitit 2000, deri në pensionim (2012), punoi në gazetën “Zëri”. (Shefqet Rexhepi)

POZHEGU Moral (1985-). Gazetar i sportit. Lindi në Prishtinë. Një kohë u mor me futboll,

luajti për të rinjtë e KF “Vëllaznimi” dhe “Kosova” e Prishtinës, po ashtu te të rinjtë, për të hequr dorë përfundimisht në atë kohë nga futblli. Pasi kreu studimet për gazetari, punën si gazetar i sportit e nisi në Radio-Gjakovë, më pas me mediumet e tjera të kryeqytetit, si gazetat “Kosova sport”, “Koha ditore”, “Gazeta express”, “Sport plus” dhe së fundmi “Zëri”, ndërkohë punoi edhe në portalet “Gazetaexpress.com”, “Infoglobi.com”, “Botasport.com”, “Fishmedia.info”, “Lajmi.net” dhe tash “Zëri.info”. (Edmond Thaçi)

PREKADINI Halim (1937-). Mjek, otorinolaringolog, doktor i shkencave të mjekësisë. Lindi në Mitrovicë, arsimin fillor dhe të mesëm i përfundoi në qytetin e lindjes. Në vitin 1957, bashkë me familjen u shpërngul për në Turqi. Në vitin 1961 shkoi në Gjermani për të studiuar në Universitetin Heidelbergut, u diplomua në vitin 1968, ndërsa tezën e doktoratës e mbrojti më 1977 po në këtë universitet. Punoi me vite si mjek i përgjithshëm në Izmir dhe në Ankara. Në periudhën 1970-1972 ishte mjek asistent në departamentin e internës dhe të kirurgjisë në spitalin shtetëror Buhen të Odensvaldit. Kreu specializimin për otorinolaringologji (ORL) në Ludgëishafen më 1975. Pas specializimit punoi në repartin e ORL-së të spitalit “Elizabeth Krankenhaus” në Straubing të Bajernit dhe si kryemjek në spitalin shtetëror të Heilbronn-it. Pastaj punoi në Shtuttgart deri më 1978, kur u kthye në Prizren. Punoi në repartin e ORL-së, në Qendrën e Mjekësisë së Përgjithshme në Prizren nga viti 1978 e deri në vitin 1991. Pas largimit nga puna hapi klinikën private në Prizren. Është autor i një përkthimi për të verbër dhe i disa punimeve profesionale. (Refik Ramku)

PREKA-LLOZANA Mysherefe (1933-). Aktore. Lindi në Prishtinë. Shkollimin fillor dhe të mesëm i kreu në vendlindje. Është njëra nga aktoret e para në Teatrin Popullor Krahinor në



MYSHEREFE
PREKA-LLOZANA

Prishtinë, ku prej 1951-1955 ka luajtur role në shumë shfaqje, si: “Zullumqari”, “Për kafshatën e bukës”, “Hani në rrugën kryesore”, “E shoqja e Hasan Agës”, “Sikur t’isha djalë”, “Zona e Zamfirit”, “Tri

botna”, “Bota”, “Personi i dyshimtë” “Nuk mar-tohem me parë”, “Nita” etj. Në po këtë teatër, në vitet 1959-1964 luajti në shfaqjet “Familja e pikëlluar”, “Lavirja e denjë për respekt”, “Zullumqari”, “Pylli”, “Zonja me kamelië”, “I ndjeri” etj. Ndërkohë, në periudhën 1955-1958 dhe më pas në periudhën 1964-1991 ishte aktore në Teatrin e Kombësive në Shkup (Drama Shqipe dhe Drama Turke), ku luajti në dhjetëra role dhe shfaqje të ndryshme. Edhe pas pensionimit, në këtë teatër dhe në disa produksione të pavarura teatrore luajti deri në vitin 2013. Më 2006 rikthehet në Teatrin Kombëtar të Kosovës, me shfaqjen “Shtëpia e Bernarda Albës”. Gjatë karrierës shumëvjeçare në teatër dhe në film, luajti mbi 130 role. Është bartëse e disa çmimeve në Maqedoni dhe në Kosovë. Më 2010 nga Ministria e Kulturës e Kosovës dhe Teatri Kombëtar i Kosovës u nderua me Çmimin Vjetor për Teatër. Jeton në Shkup. (Bekim Lumi)

PREKAZI I EPËRM. Fshat në Drenicë, 4 km në verilindje të Skënderajt. Është vendbanim i tipit të shpërndarë, me sipërfaqe rreth 1,177 ha, me lartësi mbidetare 720 m. Përmes rrugës së asfaltuar lidhet me Skënderajn dhe qendrat e tjera urbane, ndërsa përmes fshatit Tërnac lidhet me magjistralen Skënderaj-Mitrovicë. Me emrin Prekaz përmendet në defterin kadastral osman të Sanxhakut të Vushtrrisë të vitit 1566-74. Në vitin 1948 kishte 1,057 banorë, ndërsa në regjistrimin e vitit 2011 morën pjesë 2,126 banorë. Veprimtaritë kryesore ekonomike janë bujqësia dhe blegtoaria. Kultivohen drithërat, pemët, bimët foragjere etj. Ka statusin e bashkësisë lokale, ku gravitojnë vendbanimet: Arbnesh (Lubavec), Mikushnicë dhe Prekaz i Poshtëm. Nga objektet e standardit shoqëror, fshati ka shkollën 9-vjeçare, qendrën e mjekësisë familjare, disa njësi tregtare etj. Kompleksi memorial “Adem Jashari”, i ndërtuar pas luftës për të nderuar sakrificën e familjes së Jasharajve, është shndërruar në një nga pikat frekuentuese më të vizituara në Kosovë. (Ramiz Cërvadiku)

PREKAZI Luan (1946-). Futbollist, trajner. Lindi në Gjakovë, hapat e parë të futbollit i nisi në vitin 1962, te të rinjtë e skuadrës së “Trepçës”. Një vit më vonë, në moshën 17-vjeçare, debutoi për skuadrën parë të “Trepçës” dhe po ashtu ishte kapiten i përfaqësueses së të

rinjve të Jugosllavisë. Në vitin 1965, në moshën 19-vjeçare, u zgjodh sportisti i vitit në Kosovë. Për “Trepçën” zhvilloi rreth 200 ndeshje, duke luajtur edhe në ligën e dytë federative të ish-Jugosllavisë. Në vitin 1967 kaloi te “Partizani” i Beogradit dhe gjatë dy viteve e gjysmë zhvilloi 84 ndeshje zyrtare. Në vitin 1969 kaloi te “Prishtina”, ku qëndroi deri në vitin 1974, kur i dha fund karrierës si futbollist aktiv si 25-vjeçar, për shkaqe shëndetësore. Në vitin 1972, derisa ishte pjesë e klubit “Prishtina”, për herë të dytë u zgjodh sportisti i vitit në Kosovë. Në edicionin 1976/77 bëri një rikthim te “Trepça” në Ligën e parë federative të ish-Jugosllavisë, më pas tërhiqet përfundimisht nga futbollit aktiv dhe nis punën e trajnerit. Si trajner drejtoi disa skuadra të Kosovës dhe të Maqedonisë. Para luftës në Kosovë fitoi dy herë trofeun e Kupës me skuadrën “Flamurtari”, derisa pas luftës një herë me “Hysin”. Është anëtar i përhershëm i Komitetit Olimpik të Kosovës (KOK). (Arsim Maxhera)

PREKAZI Rafet (1959-). Futbollist, trajner. Lindi në Mitrovicë. Si 17-vjeçar u inkuadrua në skuadrën e parë të Trepçës, me të cilën në vitin 1976 u rendit në elitën e futbollit të ish-Jugosllavisë. Në vitin 1976 luajti në finalen e Kupës së ish-Jugosllavisë. Më 1984 bëhet pjesë e “Prishtinës”, e cila tashmë bënte gara në elitën e futbollit të ish-Jugosllavisë dhe i përket “brezit të artë” të kësaj skuadre. Pas përfundimit të karrierës si lojtar, R. Prekazi bëhet trajner i futbollit, duke drejtuar skuadrat “Trepça’89”, “Dukagjini”, “Shkëndija” e Tetovës dhe “Besiana”. Me “Dukagjinin” e Klinës e fitoi një titull të kampionit (1993/94) si dhe Kupën e Republikës së Kosovës në periudhën e pavarësimit të sportit të Kosovës. Me “Trepçën’89” u bë fitues i Superkupës së Kosovës, kurse dy herë është shpallur trajneri më i suksesshëm. Ishte përzgjedhës i përfaqësueses së Kosovës për grupmoshën U-21. (Besim Kajtazi)

PREKAZI Xhevat (1957-). Lindi në Mitrovicë. Rrjedh prej një familje sportistësh, ku veçohet edhe vëllai i tij i madh Luan Prekazi. Xh. Prekazi luajti së pari për skuadrën “Remonti” të Mitrovicës, pastaj për “Trepçën”, prej nga kaloi te “Partizani” i Beogradit, ku luajti deri në vitin 1984. Më 1984/85 luajti për “Hajdukun” e Splitit. Një kohë të shkurtër luajti në SHBA,

futboll të vogël për skuadrën “Baltimor”. Me “Partizanin” e Beogradit fitoi tre tituj të kampionit, ndërsa me fanellën e “Hajdukut” të Splitit u bë fitues i Kupës së ish-Jugosllavisë dhe luajti në gjysmëfinale të Kupës së UEFA-së. Në periudhën 1985-1991 luajti për skuadrën turke “Galatasaray”, duke fituar dy tituj të kampionit dhe u bë fitues i Kupës së Turqisë. Një stinor luajti për “Altajin” e Izmirit dhe më pas në skuadrën më pak të njohur, “Bakirköjspor”. U rikthye në Beograd, ku pak kohë luajti për një skuadër të rangut të ulët “Trudbenik”, ku përfundoi edhe karrierën e futbollistit aktiv. Jeton dhe punon si trajner në Beograd. (Besim Kajtazi)

PRELA Imzot Nikë (1918-1996). Ipeshkëv i Kishës Katolike të Kosovës. Lindi në Kotorr, Mal të Zi. Në periudhën 1941-1954 shërbeu famullitar në Sutomore e më vonë në Muo po në



IMZOT NIKË
PRELA

Mal të Zi. Gjatë shërbimit në Sutomore u burgos për arsye politike dhe tri vjet u mbajt në burgun hetues të Cetinës, ku u keqtrajtua rëndë. Më pas, në gjyqin që u mbajt në Tivar u dënua me katër vjet heqje lirie. Dënimin e vuajti në Kotorr, në kushte të rënda dhe gjithnjë i keqtrajtuar. Pas shërbimit në Muo, më 1969 u emërua ipeshkëv ndihmës për besimtarët shqiptarë të Kosovës, në kuadër të Ipeshkvisë Shkup-Prizren. U intronizua në Konkatedralen e Zojës Ndihmëtare në Prizren në janar të vitit 1970. Gjatë shërbimit të tij në Kosovë që nga viti 1981, u angazhua për njohjen ndërkombëtare të problemit të Kosovës. Dha kontribut të çmuar në aksionin e pajtimit të gjaqeve dhe në krijimin e klimës së mirëbesimit ndërmjet feve në Kosovë gjatë viteve '90. Është autor i “Fjalorit bibliik”, i shumë dokumenteve kishtarë dhe i romanit “I huaj në shtëpinë tënde”. Ishte edhe themelues i Shoqatës Humanitare Bamirëse “Nënë Tereza” në Prishtinë. Vdiq dhe u varros në Prizren. (Frok Kristaj)

PRELVUKAJ Musë (1950-). Grafist. Lindi në Martinaj, komuna e Gucisë, Mali i Zi. Kreu Akademinë e Arteve, drejtimin e grafikës në Prishtinë në vitin 1977. Grafika e tij bazohet në forma konkrete, figura kafshësh, shpe-

zësh, natyra të qeta, të realizuara në teknikën e akuatintës. Prirjen artistike e shpreh edhe më lirshëm në vizatime me motive të natyrës bimore, si trungje, rrënjë, guaca dhe kompozicione të ndryshme nga flora e fauna. Mori pjesë në shumë ekspozita kolektive: në Bienalet e Vizatimit në Prishtinë (1979-2010), pastaj në Sallonin Pranveror të Kosovës (1984-1994), në Sallonin Vjeshtor të Kosovës, në disa ekspozita të krijuesve shqiptarë në Mal të Zi (Tuz, Cetinë, Shkodër, Tiranë), pastaj në “Ekspozitën e Paqes” (Paris, 2003) etj. Hapi ekspozita personale në Prishtinë (2002) dhe në Prizren (2007). Është laureat i çmimit special për vizatim në Sallonin “28 Nëntorit” dhe “Grand Prix” në Bienalen Ndërkombëtare të Vizatimit (2010). Një kohë ishte mësimdhënës i vizatimit. (Fatmir Krypa)

PRELVUKAJ Zake (1963-). Piktore. Lindi në Martinaj të Plavës (Mali i Zi). Fakultetin e Arteve, drejtimi i pikturës dhe studimet pasuniversitare i kreu në Universitetin e



ZAKE PRELVUKAJ

Prishtinës (1997). Nga viti 1993 ligjëron lëndën e pikturës në Fakultetin e Arteve të Univeristetit të Prishtinës dhe aktualisht mban titullin e profesores së rregullt. Është anëtare e Shoqatës së Artistëve Figurativë të Kosovës dhe mori pjesë në shumë aktivitete të saj. Nga viti 1990 ka realizuar disa cikle të krijimtarisë në pikturë: “Iksat flasin”, “Arti i rezistencës”, “No comement”, “Getto in Balkan” etj. U prezantua edhe me ciklin “Trupi im brushë” dhe “Pikado”. Ekspozoi në ambiente të hapura dhe realizoi disa murale në objekte të ndryshme të Prishtinës. Hapi një sërë ekspozitash individuale, disa prej të cilave në qendra të njohura europiane. Nga viti 1990, së bashku me artistë të vendit dhe të huaj mori pjesë në shumë ekspozita kolektive, një numër syresh ndërkombëtare. Krijimtaria e saj figurative në pikturë, vizatim, video dhe performanca artistike frymon me gjetjet dhe gjurmët e rastit dhe rebelimit artistik. Është laureate e një sërë çmimesh të rëndësishme, nga të cilat disa syresh ndërkombëtare për pikturë, video dhe vizatim. (Rexhep Ferri)

PRELLUZHA. Fshat në komunën e Vushtrrisë, rreth 14 km në juglindje të qytetit, shtrihet në grykëderdhjen e lumit Llap në Sitnicë. Është vendbanim fushor i tipit të dendur. Sipërfaqja e territorit të fshatit është 745 ha. Është i banuar me popullsi serbe. Përmendet në disa dokumente mesjetare, si në kartën e Banjskës të vitit 1313, si Moçali i Prilluzhës. Është i regjistruar edhe në defterin kadastral osman të vilajetit Vëllk të vitit 1455. Përveç familjeve serbe në këtë vendbanim jetojnë edhe disa familje shqiptare të ardhur nga fshati Druar, Gllavatin, Beçuk etj. Në regjistrimin e vitit 1953 kishte 170 shtëpi me 996 banorë, ndërsa në vitin 1981 kishte 347 shtëpi me 1,746 banorë. Sipas shënimeve të komunës së Vushtrrisë, vendbanimi në vitin 1991 kishte 2,171 banorë. (Nazif Gashi)

PRENKAJ Marjan (1942-1987). Historian. Lindi në Plangçor të Gjakovës. Shkollën fillore e kreu në Skivjan, ndërsa shkollën normale në Gjakovë dhe në Pejë. Kreu studimet për histori në Fakultetin Filozofik të Prishtinës (1970), ku më pas mbaroi edhe studimet pasuniversitare dhe përgatiti tezën e disertacionit, por nuk arriti ta mbronte për shkak të sëmundjes. Punoi në Ferizaj, në Deçan dhe në Prizren si mësimdhënës i historisë dhe i sociologjisë. Punoi edhe në Entin e Mbrojtjes së Përmendoreve të Prizrenit, si kustos i Muzeut të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Nga viti 1980 filloi punë në Institutin e Historisë në Prishtinë. Botoi një numër studimesh e trajtesa shkencore dhe mori pjesë me kumtesa në shumë tubime shkencore. Punimet e tija u botuan në revistat shkencore “Kosova”, “Horizonte të historisë”, “Vjetari”. Ka botuar edhe dhjetëra biografi të luftëtarëve në edicionin “Në flakën e revolucionit”. Disertacioni i tij i doktoratës “Prizreni dhe rrethina në shekullin XIX dhe në fillim të shekullit XX” u botua në vitin 1998 nga Instituti i Historisë në Prishtinë. (Alban Dobruna)

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS. Institucioni më i lartë përfaqësues i Republikës së Kosovës. Me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (2008) përcaktohet se “Presidentin e zgjedh Kuvendi i Republikës së Kosovës me votim të fshehtë”, ka mandat pesëvjeçar, është mbipartiak dhe shpreh unitetin e popullit. Presidenti i Republikës së Kosovës, ndonëse i

votuar nga Kuvendi, ka relativisht shumë kompetenca kushtetuese sasiore, por ka fuqi simbolike politike. Nga gjithsej 30 kompetenca presidenciale, presidenti i Republikës së Kosovës i ka 25 kompetenca standarde të politikës së brendshme: përfaqësimin e Republikës së Kosovës brenda, garantimin e funksionimit kushtetues të institucioneve të përcaktuara me Kushtetutë, shpalljen e zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës, mandatin e kandidatit për kryeministër, dekretimin e ligjeve, vendosjen për gjendje të jashtëzakonshme, emërimin e komandantit të Forcave të Sigurisë së Kosovës, emërimin dhe shkarkimin e kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe të Kryeprokurorit të Shtetit, si dhe të gjyqtarëve dhe prokurorëve, të drejtorit të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, të kryetarit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, të guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, si dhe faljen e dënimeve, dhënien e dekoratave, çmimeve e shpërblimeve etj. Presidenti i Republikës së Kosovës, sipas Kushtetutës, “udhëheq me politikën e jashtme të vendit” dhe ushtron edhe disa kompetenca në këtë fushë, siç është përfaqësimi i Republikës së Kosovës jashtë vendit, pranimi i letrave kredenciale të përfaqësuesve të huaj diplomatikë të akredituar në vend, kurse në bashkëpunim me qeverinë dhe kryeministrin, nënshkruan marrëveshjet ndërkombëtare, vendos për themelimin e përfaqësive diplomatike të Kosovës në botë dhe bën emërimin dhe shkarkimin e shefave të misioneve diplomatike të Republikës së Kosovës. Ushtrimi i këtyre kompetencave presidenciale ishte i rëndësishëm sidomos në periudhën e parë, pas pavarësisht të Kosovës, në betejën për sa më shumë njohje ndërkombëtare dhe anëtarësimin e Republikës së Kosovës në organizatat ndërkombëtare dhe europiane. Kushtetuta e Kosovës i garanton presidentit “të udhëheqë me politikën e jashtme të vendit”, prej të cilave disa kompetenca i ushtron vetë dhe disa në bashkëpunim me qeverinë, siç është nënshkrimi i marrëveshjeve ndërkombëtare, pranimi i letrave kredenciale të përfaqësuesve të huaj diplomatikë të akredituar në vend, vendosjen për themelimin e përfaqësive diplomatike të Kosovës në botë (në bashkëpunim me kryeministrin), si dhe emërimin dhe shkarkimin e shefave të misioneve diplomatike të Republikës së Kosovës, bazuar në propozimin e kryeministrit.

Para shpalljes së Pavarësisë së Kosovës dhe miratimit të Kushtetutës (2008), institucioni i presidentit funksionoi në mbështetje të Kornizës Kushtetuese. Gjatë kësaj periudhe president i Kosovës ishte Ibrahim Rugova, i cili u zgjodh në këtë post në vitin 2002 dhe u rizgjodh edhe më 2004. Pas vdekjes së Rugovës (2006), president i Kosovës u zgjodh Fatmir Sejdiu, i cili në shtator të vitit 2010 dha dorëheqje për shkak të shkeljes së Kushtetutës, sepse gjatë mandatit të presidentit mbajti edhe post partiak (ishte kryetar i LDK-së). Në periudhën shtator 2010-shkurt 2011 detyrën e presidentit të Kosovës e kreu kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Jakup Krasniqi. Për një muaj (shkurt-mars 2011) postin e presidentit e ushtroi Behgjet Pacolli, zgjedhja e të cilit, po nga Gjykata Kushtetuese, u shpall e parregullt. Në prill të vitit 2011 presidente e Kosovës u zgjodh Atifete Jahjaga, mandati i së cilës përfundoi në prill të vitit 2016, kur president u zgjodh Hashim Thaçi. (Blerim Reka)

PRESPËS (E FOLMJA E). Bën pjesë në të folmet e toskërishtes veriore, përkatësisht në grupin verilindor të tyre. Flitet në Prespë me rrethinë. Fushëgropa në të cilën shtrihet Prespa vazhdon shtrirjen gjeografike edhe në shtetet fqinje, në Shqipëri dhe në Greqi. Sistemi zanor i së folmes shqipe të Prespës përbëhet nga 7 fonema zanore, të cilat realizohen në dy seri: zanore të shkurtra dhe zanore të mesme, njëjtë si në të folmet e toskërishtes veriore. Mungon seria e zanoreve të gjata dhe seria e zanoreve hundore. Diftongjet ruhen, me përjashtim të diftongut *ua*, i cili shpesh del i monoftonguar në elementin e dytë, për afërsisht si në gegërishte (grua>grù). Në këtë të folme del togu zanor *oe* (punoe, tregoe), ndërsa nga dukuritë fonetike asimilimi prek fjalët e tipit: *qaja-qehaja*, *mitrolós-mitrolóz*, *krevèt-krevàt*. Sistemi bashkëtingëllor ka një inventar prej 27 fonemash bashkëtingëllore, në të cilin mungojnë fonemat *rr* dhe *h*. Palatalizimi i *k*-së del në përemrat dëftor: *ky-qy*, *kjo-qo*, që është ndikim nga grupi perëndimor i toskërishtes veriore. Ndonëse në kontakt me gjuhët sllave të jugut, në këtë të folme ruhen mirë të tingulltat *l*, *ll* dhe ndërthemboret *th* e *dh*. *Th*-ja ndonjëherë alternon me *f* në fjalët e tipit *thëngjill-fëngjill*, *thëllëzë-fëllënxë*, ndërsa fonema *z* si parashtesë alternon me fonemën

x. Ruhen të gjitha grupet e bashkëtingëlloreve, ndërkohë që shurdhohet elementi i dytë i tyre i zëshëm në pozicionin fundor të fjalës. Vërehet tendenca që emrat e gjinisë asnjane të kalojnë në gjininë mashkullore. Sistemi rasor i kësaj të folmeje njih edhe rasat vendore dhe thirrmore, ndërsa nga sistemi përemëror me interes dalin trajtat e rrjedhores, të cilat rrjedhin nga trajtat e emërores *mua* (*meje*) të shoqëruara me parafjalën *pe* (*pe mua-pe meje*). Paskajorja del si në gjithë toskërishten, përpos rasteve kur formohet me pjesëzën *pa+pjesorja e foljes* (*pa marë ti-për të marrë ti*), ndërsa përcjellorja ndërtohet me pjesëzën *dyke+pjesorja e foljes* (*dyke shkuar*). Në fushë të sintaksës nuk dalin dallime nga grupi verilindor i toskërishtes. Duke qenë në kontakt me gjuhët sllave të jugut, e folmja e Prespës ka huazuar numër të konsiderueshëm fjalësh. (Haki Hysenaj)

PRESTRESHI Mulla Sadri (1917-2002). Titullar i fesë islame, aktivist i NDSH-së, veteran i arsimit. Lindi në fshatin Mazgit të Obiliqit. Mësimet e para i mori në Obiliq, ndërsa gjatë viteve 1930-1939 mësoi në Medresenë "Pirinaz" të Prishtinës. Më 1941 ndoqi kursin administrativ për nëpunës dhe po këtë vit i vazhdoi mësimet në Medresenë "Sulltan Selim" të Prishtinës. Pas Medresesë u dekretua imam-ofiqar në Xhaminë e fshatit Dobrajë e Madhe të komunës së Lipjanit, ku punoi edhe si mësues. Pas Luftës së Dytë Botërore u përfshi në Lëvizjen Nacional Demokratike Shqiptare (NDSH). Më 1946 u arrestua dhe u dënua nga Gjykata Ushtarake e Divizionit të Prishtinës me 4 vjet heqje lirie dhe punë të detyrueshme. Pas daljes nga burgu (1948) u emërua mësues në shkollën fillore të Obiliqit, ndërsa një vit më vonë u transferua në shkollën fillore të Korroticës së Poshtme të komunës së Drenasit. Më 1969 u emërua mësimdhënës në Medresenë "Alaudin" të Prishtinës, ku punoi deri në pension (1983). (Ramadan Shkodra)

PRESHEVA. Qytezë në Luginën e Preshevës, shtrihet në shpatet lindore të Karadikut të Preshevës, në daljen e lumit të Kurbalisë në fushën e Moravicës, në lartësinë mbidetare 450-540 m. Në afërsi të Preshevës kalojnë rrugët automobilistike dhe hekurudhore me rëndësi ndërkombëtare. Gjetjet arkeologjike dëshmojnë për ekzistimin e një vendbanimi të lashtë në afërsi të qytezës. Nga mesi i shekullit



PRESHEVA

XV, Presheva bie nën sundimin e Perandorisë Osmane dhe mbetet në kuadër të saj deri në vitin 1912. Për shkak të pozitës së volitshme gjeokomunikative dhe kushteve natyrore, Presheva shumë herët moti karakteristika dhe funksione të qendrës, ku gravitojnë shumë vendbanime. Një zhvillim të hovshëm pati në pjesën e dytë të shekullit XIX, kur merr funksionin e selisë administrative të Kazasë së Preshevës. Pas vitit 1912 ishte qendër e rrethit, në kuadër të qarkut të Kumanovës (Banovina e Vardarit). Pas vitit 1947 selia e rrethit nga Presheva transferohet në Bujanoc. Sipas regjistrimit të vitit 1961 në Preshevë kanë jetuar 5,680 banorë, ndërsa në strukturën etnike me numër më të madh marrin pjesë shqiptarët me 2,897 banorë, serbët me 1,650 banorë, pastaj turqit, romët, malazezët etj. Ndërkaq, Në vitin 2002 në Preshevë jetonin 13,426 banorë, prej të cilëve 87,5% shqiptarë. Për shkak të kushteve të vështirësuar ekonomike dhe të rrethanave politike, nga qyteza dhe nga Lugina e Preshevës është shpërngulur një numër i madh banorësh qoftë në botën e jashtme, qoftë në Kosovë. Pas Luftës së Dytë Botërore në Preshevë hapen disa reparte industriale, të cilat u mbyllën në fillim të viteve '90. Forma e vetme e aktivitetit ekonomik gjatë kësaj periudhe vazhdon të jetë tregtia, e cila zhvillohet në kushte të informalitetit dhe nuk sjell dobi të mjaftueshme ekonomike. Si qendër komunale qyteti i Preshevës me funksionet administrative, shëndetësore, arsimore, kulturore e tregtare që ka, ofron shërbime për popullsinë e qytetit dhe të fshatrave përreth. (Arsim Ejupi)

PRESHEVA (komuna). Shtrihet në Luginën e Preshevës, në lartësi mesatare mbidetare 460 m, me sipërfaqe prej 264 km². Përfshin fushën

e Preshevës dhe skajet kodrinore-malore të Karadakut në perëndim, përkatësisht të Rujanit në lindje. Në perëndim kufizohet me komunën e Gjilanit, në veri dhe lindje me komunën e Bujanocit, ndërsa në jug me komunën e Kumanovës dhe Likovës në Maqedoni. Nëpër territorin e komunës së Preshevës kalojnë vijat e rëndësishme të komunikacionit rrugor, si rruga automobilistike ndërkombëtare Beograd-Nish-Shkup dhe rruga hekurudhore Beograd-Shkup-Selanik (Korridor X). Gjatë kohës së Perandorisë Osmane bënte pjesë në kazanë e Preshevës, e cila përfshinte edhe pjesën dërrmuese të komunës së Bujanocit e Tërgovishtës. Në Mbretërinë Jugosllave rrethi i Preshevës bënte pjesë në banovinën e Vardarit. Pas Luftës së Dytë Botërore, me ndarjet e reja administrative, ajo shkëputet nga lidhjet e natyrshme funksionale prej Kumanovës e Gjilanit dhe lidhet me Vranjën në Serbi. Konfigurimi gjeomorfologjik i relievit është mjaft i përshtatshëm. Pjesët e larta të relievit ndërtohen nga gnejset, mikashistet, filitet me ndërfitje të shpeshta të mermerëve. Pjesa fushore është e ndërtuar nga shkëmbinj të palidhur ranorë dhe argjilorë. Më të përhapura janë sedimentet aluviale të kuartarit, argjilat ranore deluviale, proluviale, zhavorret etj. Klima është e mesme kontinentale, me temperaturë mesatare prej 10.5^oC. Në aspektin klimatik rëndësi të madhe ka hapja në anën jugore, nga e cila përmes luginës së Vardarit depërtojnë ndikimet klimatike prej detit Egje. Mesatarisht bien 730 mm reshje. Lumi më i rëndësishëm është Moravica, degë e djathtë e Moravës Jugore.

Në vitin 2002 në komunën e Preshevës jetonin 47,661 banorë në 35 vendbanime. Prej tyre, 39.4% jetojnë në vendbanime urbane dhe 60.4% në vendbanime rurale. Vendbanimet e zonës kodrinore-malore të Karadakut të Preshevës dhe Rujanit janë përfshirë nga valët intensive të shpërnguljes, të cilat tanimë kanë marrë përmasa të shpopullimit. Me të ardhura kombëtare prej vetëm 16.2% në raport me mesataren e papunësisë dhe shkallën e papunësisë prej 60%, komuna e Preshevës është komuna më e pazhvilluar në Serbi. (Arsim Ejupi)

PRESHEVA Avni (1944-). Filozof, mësime-dhënës universitar. Lindi në Preshevë, ku kreu shkollën fillore dhe të mesme. Studimet

për filozofi i kreu në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Sarajevës, ku mbaroi edhe studimet pasuniversitare, kurse tezën e disertacionit e mbrojti në Universitetin e Prishtinës. Në periudhën 1975-2009 punoi mësimdhënës universitar në katedrën e filozofisë të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës, ku ligjëroi lëndë nga fusha e logjikës. Është autor i artikujve shkencorë dhe i studimeve kryesisht nga fusha e filozofisë së gjuhës dhe e logjikës me metodologji, si dhe i disa librave po nga këto fusha: “Filozofia e gjuhës” (1998), “Prej gjuhës në gjuhë” (2005), “Gjuha dhe metagjuha” (2009) etj. (Albulena Alushaj)

PRESHEVA Enis (1933-1994). Ekonomist, aktivist politik në sektorin ekonomik. Lindi në Mitorvicë, ku mbaroi shkollën fillore, shkollën e mesme ekonomike e kreu në Pejë, kurse Fa-



ENIS PRESHEVA

kultetin Ekonomik në Beograd. Ishte njëri ndër ekonomistët e parë të diplomuar shqiptarë të Kosovës. Kreu shumë detyra me përgjegjësi në ekonominë e Kosovës, veçanërisht në Kombinatit “Trepça”, ku e zhvilloi pjesën më të madhe të aktivitetit, duke qenë pjesë e një ekipi që bëri rilindjen e këtij kombinati gjatë viteve ‘70. Atij i atribuohet edhe themelimi i organizatës “Trepça komerc”, e cila pati ndikim të madh në zhvillimin e “Trepçës” në vitet ‘80 të shekullit të kaluar. Atij gjithashtu i atribuohet edhe themelimi i Bankës së Kosovës dhe ishte drejtor i parë i saj. Një kohë ka qenë mësimdhënës në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës, në fushën e analizës financiare. (Selman Selmanaj)

PRESHEVËS (E FOLMJA E). Si e folme e Preshevës kuptohet idioma gjuhësore shqiptare e luginës që lidh basenin e Vranjës me atë të Kumanovës, duke përfshirë këtu vetë qytezën e Preshevës, si qendër e kësaj të folmeje. Bën pjesë në gegërishten verilindore. Veçantitë dialektore të kësaj të folmeje dalin në të gjitha fushat, por më të theksuarat janë në fushë të fonetikës e të morfologjisë. Ka shtatë zanore, të cilat dalin në seri të ndryshme. Të tjerat realizohen edhe si të hundorëzuara dhe të gjata,

tipare këto që i vënë në raporte kundërvënese seritë: hundore-gojore, të shkurtra-të gjata. Hundorësia e zanoreve nuk ruhet mirë në këtë të folme, edhe kur shfaqet intensiteti i këtij tipari fizik është më i dobët se në idiomat e tjera të gegërishtes. Zanorja *e* nuk shfaqet si hundore, ndërkohë zanorja *a* e ka ruajtur më së shumti këtë tipar. Tingulli *ë* në pozitë të patheksuar ka rënë tërësisht, ndërsa tingulli *y* ka prirjen e delabializimit në Bujanoc me rrethinë. Vërehet tendenca e monoftongimit të grupeve *ue, ie*. Kjo idiomë gjuhësore dallon për ruajtjen e çifteve qiellzore-afrikate (*q:gj-ç:xh*). Faringalja *h* bie në pozicionin final të fjalës, ndërkohë që ruhet kundërvënja *r-R*. Mungon gjinia asnjëse, ndërsa në formimin e shumësit të emrave vërehet dukuria e rrafshimit të kundërvënies qiellzore-afrikate. Emrat që mbarojnë me zanore të gjata: *â, î* dhe *ë*, duke e bërë trajtën e shquar me *i*, shpifin bashkëtingëlloren epentetike *v: vlla-v-i, dhe-v-i*. Mungojnë emrat ambigjenë. Ruhet *ë*-ja e mbaresave të gjinore dhe dhanores: *babës, lopës, nonës*. Për formimin e mbiemrave nga foljet në këtë të folme përdoret prapashtesa *-ëm: i pasëm, i lagëm*. Veta e parë shumës e foljeve që dalin me temë në zanore, në kohën e tashme të dëftores, gjithnjë merr mbaresën *-jmi: punojmi, shkojmi*, ndërsa veta e tretë njëjës e foljeve në të tashmen e lidhores del në trajtën: *le t' shkoje, le t' punoje*. Foljet e tipit *boj* dhe *shti*, në numrin shumës të kohës së kryer të thjeshtë, ruajnë tingullin epentetik *-n: bonëm, shtinëm*. Në fushë të leksikut ka ndikime nga turqishtja dhe serbishtja. (Haki Hysenaj)

PRETENI Hasan (1961-). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), drejtor i Agjencisë për Antikorrupsion të Kosovës. Lindi në Mitrovicë. Pas shkollës së mesme tekniko-ushtarake në Zagreb, kreu Fakultetin Juridik në Prishtinë (1988). Më 1986 mbaroi edhe shkollën e gjuhëve të huaja. Punoi në Armatën Jugosllave deri më vitin 1991. Më pas punoi në Këshillin për Financim në Mitrovicë, deri në 1998. Me formimin e Brigadës 141 “Mehë Uka” më 30 qershor 1998 u emërua komandant i batalionit të tretë të kësaj brigade. Pas mbarimit të luftës kreu detyra me përgjegjësi në Trupat Mbrojtëse të Kosovës (TMK). Pas largimit nga TMK-ja, në periudhën 2006-2016 kreu funksionin e drejtorit të Agjencisë Antikorrupsion të Kosovës. (Emin Musa)

PRETENI Nuhi (1937-1998). Inxhinier i xehtarisë, profesor universiteti. Lindi në Melenicë të Mitrovicës. Shkollën fillore e kreu në Stantërg, kurse gjimnazin në Mitrovicë. Studimet i përfundoi në Fakultetin e Xehtarisë, të Gjeologjisë dhe të Naftës në Universitetin e Zagrebit (1966). Studimet pasuniversitare i mbaroi në të njëtin fakultet, ndërsa tezën e disertacionit të doktoratës e mbrojti në Universitetin e Prishtinës (1997). Punoi si inxhinier i prodhimit në minierën e Kishnicës dhe të Novobërdës. Më pas u zgjodh ligjërues në Shkollën e Lartë Teknike në Mitrovicë. Një kohë ishte edhe këshilltar për xehtari në Bankën e Kosovës dhe drejtues i institutit të saj. Botoi një numër të konsiderueshëm të punimeve shkencore, është autor i teksteve universitare: “Matjet në Miniera”, “Fjalorit teknik në trajtimin e termave nga fusha e xehtarisë”, “Udhëzuesit minerarë”. Ishte udhëheqës dhe bashkëpunëtor në shumë projekte nga lëmi i minierave. Deri në fund të jetës punoi profesor në Fakultetin e Xehtarisë dhe të Metalurgjisë në Mitrovicë. (Islam Fejza)

PRETENI Raif (1961-). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Lindi në fshatin Melenicë të Mitrovicës. Kreu Shkollën e Policisë në Vushtrri dhe më pas mbaroi Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës. Nga viti 1981 deri 1989 punoi në Policinë e Kosovës në Pejë. Për shkak të kundërshtimit të ndryshimeve kushtetuese në vitin 1989, u largua nga puna. Nga viti 1998 u angazhua në aktivitetet e UÇK-së në Zonën Operative të Shalës, ku kreu detyrën e ndihmëskomandantit të Brigadës 141 “Mehë Uka”. Gjatë luftës u plagos rëndë. Pas luftës u angazhua në Trupat Mbrojtëse të Kosovës dhe në Forcën e Sigurisë së Kosovës. (Haxhi Ademi)

PREVALLA. Lokalitet në pjesën verilindore të komunës së Prizrenit, shtrihet në lartësi mbidetare mbi 1500 m dhe gjendet në rrugën magjistrale Prizren-Shtërpçë-Ferizaj. Është larg nga qyteti i Prizrenit rreth 25 km. Hapësira e Prevallës shtrihet brenda territorit të Parkut kombëtar “Sharri” dhe është e pasur me vlera të shumta të biodiversitetit. Kushtet atmosferike të kësaj hapësire janë mjaft të veçanta. Takohen tri tipe klimatike, duke përfshirë edhe elementet e modifikuara të klimës mesdhetare që depërtojnë përmes grykës së Lumbardhit



PREVALLA

të Prizrenit, klimës kontinentale që arrin nga brendësia e territorit të Kosovës dhe klimës malore, e cila kushtëzohet nga lartësia mbidetare e zonës. Gërshetimi i këtyre tipave të klimës manifestohet me ndryshime shumë të shpeshta të motit. Për shkak të kushteve bioklimatike që ka, Prevala njihet për vetitë shëruese dhe paraqet një pikë frekuentuese të turizmit dhe të piknikut. (Hazer Dana)

PRIFTI Kristaq (1932-2017). Historian, profesor universiteti, akademik. Lindi në Berat. Studimet i kreu në Fakultetin e Historisë, në Institutin Pedagogjik të Moskës (1951-1955). Në periudhën 1955-1975 ishte pedagog i historisë së Shqipërisë në Fakultetin e Histori-Filologjisë të Universitetit të Tiranës (UT) dhe gjatë viteve 1969-1975 dekan i Fakultetit Histori-Filologji në UT. Në vitet 1982-1993 ishte punonjës shkencor në Institutin e Historisë, përgjegjës i Sektorit të Rilindjes dhe më pas i departamentit të historisë së sotme të Kosovës. Më 1991-1993 ishte drejtor i Institutit të Historisë. Ka mbajtur ligjërata për disa vjet me radhë (1972-1980) në studimet pasuniversitare në degën e historisë në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Është autor i një numri studimesh dhe i monografive autoriale dhe në bashkautorësi: “Kongresi i Manastirit - ngjarje me rëndësi në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare (me Sh. Demiraj, 1968); pastaj “Lidhja Shqiptare e Pejës. Lëvizja Kombëtare 1896-1900” (1984) dhe varianti frëngjisht i botuar në vitin 1989; “Historia e Shqipërisë”, vëll. II (1984); “Dervish Hima. Jeta dhe vepra” (1987); “Dr. Ibrahim Temo. Jeta dhe Vepra” (1996); “Kosova në vështrimin enciklopedik” (1999); “Historia e Popullit Shqiptar”, Vëll. II, (2002); “Popullsia e Kosovës, 1831-1912”

(2014) etj. K. Prifti ka marrë pjesë në shumë konferenca dhe aktivitete të tjera shkencore në Shqipëri dhe jashtë saj, si dhe ka botuar artikuj shkencorë në revista të ndryshme. Është anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. (Jusuf Bajraktari)

PRILEPCI (Preiliepaç/Lipovac). Qytet dhe fortifikatë mesjetare në rrethinë të Novobërdës. Nga gjetjet e kulturës materiale konsiderohet njëri ndër vendbanimet më të vjetra të arealit të Novobërdës. Në luginën e lumit Përlepnice (Prilepnice) gjenden mbetje të një fortifikate, për të cilën nuk kemi të dhëna, përkatësisht mungojnë hulumtimet shkencore. Ky lokalitet shtrihet rreth 12 km në juglindje të Novobërdës dhe shërbente si mburojë e saj. Me emrin e njëjtë Prilep përmendet në dokumente të shkruara në kartën e Lazarit, me të cilën në vitin 1381 e themelon Manastirin e Ravinicës. Në burimet raguzane përmendet në vitet 1424/1425 (*subtus castrum Preiliepaç prope Nouam Berdam*). Nga ndonjë studiues Prilepci është identifikuar me lokalitetin Lipovac në katundin Bozhevc në afërsi të Novobërdës, ndërsa në burime bizantine përmendet një qendër kishtarë e quajtur Prinipon, vendndodhja e të cilit nuk dihet deri tani. Ka të ngjarë që emri Prinipon në gjysmën e parë të shek. XIV është shndërruar në Prilepac, përkatësisht në vitin 1329 e ndeshim me këtë emër si vendlindje të Lazar Hrebëlanoviqit, i njohur më vonë si knez Lazar. Prilepci me emër Tash Hisar (fortifikatë guri) përmendet edhe në kronika osmane, pak ditë pas rënies së Novobërdës (1455).

Terreni ku është ndërtuar qyteti-fortifikatë është kryesisht shkëmbor, me pjerrësi të madhe, i pakalueshëm nga pjesa jugore dhe veriperëndimore. Muret janë ndërtuar me gurë të madhësive të ndryshme dhe i janë përshtatur terrenit, prandaj fortifikata është ndërtuar në formë katërkëndëshi të çrregullt. Muret shtrihen në një gjatësi rreth 120 m, ndërsa në gjerësi rreth 20 m. Sipërfaqja kornizë e fortifikatës kap rreth një hektar. Nga kjo fortifikatë mund të mbahej nën vëzhgim ultësira e lumit Përlepnica, në drejtim të qytetit dhe kështjellës së Novobërdës, përfshirë edhe luginën e Moravës së Binçës dhe të gjitha viset e Malit të Zi të Shkupit. (Faik Sahiti)

PRISHTINA (GJINOLLI) Alidanish (shek. XIX-XX). Njëri ndër qeveritarët e njohur të familjes feudale Gjinolli, anëtar i Komitetit të

Stambollit dhe aktivist i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Ishte i biri i Abdurrahman Pashës. Emri i tij gjendet në një memorandum drejtuar më 20 qershor 1878 ministrave të jashtëm të Fuqive të Mëdha, në mesin e personaliteteve të shquara shqiptare në Stamboll, bashkë me Abdyl Frashërin, Pashko Vasën etj. Në zgjedhjet parlamentare osmane të vitit 1912, për sanxhakun e Prishtinës njëzëri ishte pranuar kandidatura e Hasan Prishtinës dhe Alidanish Beut për deputet të këtij sanxhaku. A. Beu më pas ishte ministër në qeverinë turke dhe më vonë ambasador i Turqisë në Moskë. (Aliriza Selmani)

PRISHTINA. Kryeqytet i Republikës së Kosovës, qyteti më i madh i saj, qendër e komunës me të njëjtin emër. Shtrihet në pjesën lindore të Kosovës, në luginat e lumenjve Prishtevkë e



PRISHTINA

Vellushë, në lartësi mesatare mbidetare rreth 600 m. Pozita qendrore në Gadishullin Ballkanik dhe kryqëzimi i rrugëve në territorin e saj mundësuan lidhjen e mirë me detin Adriatik, por edhe me pjesët e tjera të Ballkanit dhe me Europën. Largësia mesatare e qendrave të rëndësishme të rajonit nga qyteti i Prishtinës sillen rreth 300 km, që mund të konsiderohet si një distancë e favorshme: Shkupi 86 km, Tirana 330 km, Beogradi 360 km, Podgorica 298 km. Kjo pozitë e volitshme i mundësoi Prishtinës qysh herët të ketë funksione të rëndësishme tregtare, zejtare, politike e kulturore.

Gjurmët e para të banimit në territorin e Prishtinës datojnë që nga periudha e neolitit, rreth 6 mijë vjet më parë, ndërsa hulumtimet arkeologjike (Matiçan, Graçanicë, Tjerrtorja, Ulpianë) dëshmojnë se jeta në këto territore nuk është ndërprerë asnjëherë deri sot.

Gjatë sundimit romak, në afërsi të Prishtinës u ngrit qyteti i njohur Ulpiana (Urbus splendissima), që njihej si qendër e Dardanisë ilire. Pas rënies dhe braktisjes së Ulpianës, në veriperëndim të saj u ngrit dhe u zhvillua Prishtina. Ajo përmendet për herë të parë si fshat i pafortifikuar nga Perandori Bizantin, Johan Kantakuzen, në vitin 1342. Zhvillimi i tregtisë dhe xehetarisë ndikuan në përparimin dhe zgjerimin e qytetit. Prishtina si qendër ekonomike kishte edhe tregun e vet, ndërsa përmendet edhe si qendër e organizimit të lojërave me kalorës. Gjatë shekullit XIII-XIV Prishtina merr tipare urbane, kur bëhet qendër e rëndësishme xehetare dhe tregtare në rrugën Dubrovnik-Stamboll. Gjatë pushtimit osman në Prishtinë vendoset selia e sanxhakut, ndërsa në vitin 1530 shënohet si kasaba dhe stacion i rëndësishëm i rrugës Selanik-Sarajevë. Gjatë shek. XVII-XVIII, Prishtina pati një zhvillim të ngadalshëm, për shkak të luftërave dhe zjarreve, që e dogjën disa herë, ndërsa në shek. XIX fillon rimëkëmbja e saj. Ajo merr funksione të rëndësishme si qendër tregtare, por edhe si qendër politike dhe administrative. Në vitin 1877 Prishtina bëhet qendër e vilajetit të Kosovës. Gjatë këtij shekulli u hapën disa konsullata të vendeve europiane, si ajo e Francës, e Anglisë, e Austrisë etj. Mirëpo, me largimin e qendrës së vilajetit në Shkup në vitin 1888, Prishtina humbi rolin administrativ dhe politik që e kishte.

Situatat e pavolitshme politike që e përcollën vazhdimisht, u reflektuan edhe në dinamikën e popullsisë. Derisa në vitin 1623 Prishtina kishte 2,060 banorë, ndërsa pas rreth 200 vitesh (1863) arriti të kishte rreth 10,000 banorë. Sipas E. Qelebiut, në vitin 1660 Prishtina kishte 2,600 shtëpi, çarshinë ku zhvillohej tregtia dhe zejtaria, 300 dyqane, 11 hane, dy hamame, ndërsa në vitin 1838 ajo kishte 1,500 shtëpi. Sipas konsullit serb, B. Nushiç, në vitin 1902 Prishtina kishte 3,760 shtëpi në 13 lagje me rreth 18,800 banorë. Çarshia kishte 500 dyqane dhe 12 hane. Gjatë periudhës së Mbretërisë Jugosllave, Prishtina nuk pati prosperitet. Në vitin 1912 u pushtua nga Serbia, dhe me këtë rast, për shkak të dhunës dhe terrorit, shumë familje shqiptare u detyruan të shpërnguleshin për në Turqi. Shumë lagje u braktisën, kurse çarshia e dikurshme e humbi pamjen dhe vlerën që kishte, sepse shumica e zejtarëve u larguan nga aty. Në vend të tyre u vendosën kolonë

serbë, pushtetarë, nëpunës, ushtarakë etj. Aktivitete kryesore ekonomike ishin bujqësia e blegtoria, grumbullimi i drithërave, i kafshëve dhe prodhimet blegtorale, që transportoheshin në viset e tjera. Gjatë kësaj periudhe numri i popullsisë u rrit ngadalë, nga 14,760 banorë në vitin 1921, në 16,350 banorë në vitin 1931, kurse sipërfaqja e qytetit ishte 193 ha.

Pas Luftës së Dytë Botërore (1947) Prishtina bëhet kryeqytet i Kosovës, me çka merr hov urbanizimi i saj. Ajo ndryshon fizionominë, duke u shndërruar në një qytet bashkëkohor, me komplekse të reja banesore dhe shoqërore përgjatë lumit Prishtevka dhe Vellusha dhe me zonën industriale në drejtim të Fushë-Kosovës. Në qytetin e Prishtinës u vendosën organet qendrore të krahinës së atëhershme, institucionet e rëndësishme arsimore, shkencore, shëndetësore e kulturore. Industria filloi të marrë hov (fabrika e tullave, kombinati i ndërtimit, fabrika e tekstilit, kombinati bujqësor industrial, fabrika e amortizatorëve) dhe kjo u reflektua në ndërtimin e godinave shumëkatëshe, në zgjerimin e infrastrukturës, të objekteve hoteliere, institucioneve të rëndësishme të kulturës, të arsimit dhe të administratës. Nga fundi i viteve '60 u hapën ose u rihapën shumë institucione me rëndësi: Instituti Albanologjik, Universiteti, Teatri, Radiotelevizioni i Prishtinës, Pallati i Shtypit, Arkivi i Kosovës, Muzeu i Kosovës, Pallati i Rinisë, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Galeria e Arteve, Biblioteka Kombëtare Universitare etj.

Në periudhën 30-vjeçare (1968-1999) Prishtina ishte qendër e vlimeve politike dhe e lëvizjes popullore për liri: demonstratat e vitit 1968, demonstratat e vitit 1981, manifestimet e viteve '90 kundër regjimit serb, pas të cilave u ndërmor një represion masiv i pushtetit serb mbi popullatën vendase, duke shkelur çdo të drejtë elementare. Në vitin 1999 pjesa dërrmuese e popullsisë së Prishtinës u dëbua me dhunë, për t'u kthyer masovikisht në vatrat e tyre, pas hyrjes së forcave të NATO-s në qershor të po këtij viti. Më 17 shkurt të vitit 2008 Kuvendi i Kosovës shpalli në Prishtinë Pavarësinë e Kosovës. Pas luftës së vitit 1999 Prishtina pati një rritje të shpejtë, si për nga numri i popullsisë, ashtu edhe në zgjerimin territorial. Popullsia e qytetit u rrit nga 19,600 banorë në vitin 1948, në 109,200 banorë në vitin 1981 dhe rreth 200,000 banorë në vitin

2011, ndërsa sipërfaqja u zgjerua nga 223 ha sa ishte në vitin 1948, në 1,600 ha në vitin 2011. Sipas disa vlerësimeve sot në qytetin e Prishtinës jetojnë rreth 350,000 banorë. (Ibrahim Ramadani)

PRISHTINA (komuna). Komunë në pjesën lindore të Kosovës, me qendër qytetin me të njëjtin emër. Sipërfaqja: 572 km² numri i popullsisë rreth 450,000 banorë dhe dendësia mesatare 787 ban/km². Përfshin territorin e Gollakut dhe një pjesë të vogël të Rrafshit të Kosovës. Në veri kufizohet me komunën e Podujevës, në verilindje me Serbinë, në lindje dhe juglindje me komunën e Kamenicës dhe të Novobërdës, në jug me komunën e Lipjanit dhe në perëndim me komunën e Fushë-Kosovës dhe të Obiliqit. Është njëra nga komunat më të mëdha të Kosovës, si për nga sipërfaqja, ashtu edhe për nga numri i popullsisë. Territori i Komunës së Prishtinës në kuptimin e përgjithshëm gjeografik ndahet në dy tërësi kryesore hapësinore: zona lindore kodrinore-malore dhe zona perëndimore e rrafshët. Pjesa më e madhe e territorit të komunës shtrihet në viset kodrinore-malore të Gollakut (80%), kurse në perëndim një pjesë më e vogël e saj shtrihet në Rrafshin e Kosovës (20%). Kufiri ndërmjet këtyre zonave ndodhet në vijën kontaktuese të pjesës fushore dhe asaj kodrinore-malore, në drejtimin veri-jug. Në disa pjesë kjo vijë depërton përgjatë luginave lumore në lindje, siç është rasti me luginën e Graçanicës dhe të Prishtinës. Diferenca hipsometrike shkon nga 550 m në perëndim, deri mbi 1,100 m në lindje. Luginat lumore (Graçanica dhe Prishtevka) depërtojnë thellë në masivin malor, duke u mundësuar shumë vendbanimeve të kësaj ane lidhje të mira komunikuese me qendrën. Përgjatë luginës së Teneshdollit kalon hekurudha dhe rruga automobilistike Prishtinë-Podujevë-Merdar, që shkon në drejtim të Europës Qendrore. Përmes luginës së lumit Graçanica, Prishtina lidhet me Gjilanin e Kamenicën, por edhe me Luginën e Preshevës, ndërsa përgjatë luginës së lumit Prishtevka shtrihet magjistralja që lidh Keqekollën me rrethinë, por edhe viset përtej kufirit të banuara me popullsi shqiptare.

Klima e komunës së Prishtinës ka karakteristika kontinentale, me disa dallime ndërmjet viseve të rrafshëta dhe atyre malore në lindje, me reshje të pakta dhe luhatje të madhe të

temperaturës ditore dhe vjetore. Vlera mesatare e temperaturës së ajrit në Prishtinë është 10.2^oC. Muaji më i ftohtë është janari me temperaturë mesatare 1.5^oC, ndërsa më i nxehti është gushti me 20.5^oC. Amplituda vjetore e temperaturës së ajrit është 21.9^oC. Temperatura mesatare e ajrit në sezonin e dimrit (janar-shkurt) është 0.1^oC, gjatë pranverës 9.7^oC dhe në vjeshtë 11.2^oC. Temperatura absolute minimale gjatë dimrit arrin deri -27^oC. Në viset malore të komunës dimri është më i ashpër dhe temperatura mesatare e janarit është -3^oC, ndërsa vera është më e freskët. Komuna e Prishtinës merr sasinë më të vogël të reshjeve në Rrafshin e Kosovës. Sasia vjetore e reshjeve është rreth 582 mm në vit. Muaji me të reshura më të dendura është maji, ndërsa bora në disa pjesë të larta malore qëndron më gjatë.

Rrjeti hidrografik në komunën e Prishtinës është pak i zhvilluar, por edhe me sasi të vogël të prurjes së ujit. Lumenjtë më të rëndësishëm që rrjedhin nëpër territorin e kësaj komune janë: Prishtevka, Vellusha, Graçanica dhe Ballabani. Të gjithë këta lumenj burimin e kanë në territorin e komunës së Prishtinës, çka do të thotë se janë të shkurtër. Lumenj që burimin e kanë jashtë komunës së Prishtinës dhe kalojnë nëpër të janë: lumi Llap (9 km) në pjesën veriore dhe Lumi i Shtrembër (10 km) në pjesën juglindore. I tërë territori i komunës së Prishtinës i takon pellgut të Detit të Zi. Shumica e ujërave të komunës derdhen në lumin Sitnica dhe në Llap, kurse një pjesë e vogël derdhet në Moravë të Binçës. Për furnizimin e popullsisë me ujë, në komunën e Prishtinës është ndërtuar liqeni i Badovcit në lumin e Graçanicës me sipërfaqe 1.6 km² dhe vëllim prej 31 mil/m³ ujë. Liqeni i Batllavës në anën veriore futet pak në territorin e komunës, por është me rëndësi të madhe për Prishtinën dhe rrethinën e saj.

Gjurmët e hershme të banimit në territorin e Prishtinës i takojnë parahistorisë që nga neoliti i hershëm, epoka e bronzit e deri te etnokultura dardane pas epokës sonë. Gjetjet arkeologjike në lokacionin e Badovcit, Glladnicës, Matiçanit, Tjerrtores dëshmojnë se territori i komunës së Prishtinës ishte i banuar që nga koha e neolitit. Në Badovc dhe Bërnice të Poshtme janë gjetur stoli nga bronzi, kurse në afërsi të Prishtinës janë gjetur gërmadhat e vendbanimit të shek. II para epokës së re, që mendohet të jetë Ulpiana si qytet i lashtë i periudhës romake. Edhe Manastiri i

Graçanicës u ngrit mbi themelet e një ndërtimi të hershëm paleokristian. Falë pozitës së mirë gjeografike, qyteti i Prishtinës u bë qendër e rëndësishme për rrethinën e saj e më gjerë. Nëpër territorin e kësaj komune kalonin rrugë të rëndësishme që nga lashtësia, të cilat çonin në brendi të Gadishullit Ballkanik dhe në Europën Qendrore. Rëndësia e pozitës gjeografike të qytetit të Prishtinës shpjegohet që nga kohërat e hershme, me lidhjet e mira që kishte me rajonet përreth. Në kohën antike nëpër territorin e kësaj komune kalonin dhe kryqëzoheshin rrugët që lidhnin Lezhën, Prizrenin, Prishtinën dhe Nishin (Lissum-Theranda-Ulpiana-Naissus) dhe rruga e Egjeut që lidhte Selanikun, Shkupin, Prishtinën dhe Zveçanin me Europën Qendrore (Thessalonica-Scupi-Ulpiana-Municipium DD). Përgjatë këtyre rrugëve në periudhën romake u ndërtuan disa fortesa, si në Bellaqec, Teneshdoll, Barilevë, Siçevë etj.

Territori i komunës ishte edhe arenë e shumë betejave që u zhvilluan gjatë historisë. Në vitin 1389 në Gazimestan afër Prishtinës u zhvillua Beteja e Kosovës ndërmjet koalicionit ballkanik dhe Perandorisë Osmane, ndërsa në vitet 1839-1844 njihen aksionet e armatosura kundër reformave të Tanzimatit dhe kryengritja e Prishtinës. Pas largimit të Perandorisë Osmane më 1912, territori i komunës pushtohet nga Serbia, që ushtron dhunë e terror mbi popullsinë shqiptare. Nga viti 1862-1878 në territorin e komunës u vendosën shumë muhaxhirë shqiptarë të dëbuar nga sanxhaku i Nishit, ndërsa pas pushtimit serb filloi edhe kolonizimi sllav. Gjatë periudhës së sundimit serb, në shumë vendbanime të komunës u vendosën me mijëra serbë në Prishtinë, Hajvali, Çagllavicë, Barilevë, Bërnice, Badovc etj.

Gjatë historisë komuna ka pasur ndryshime të vazhdueshme në organizimin administrativ. Territori i komunës së Prishtinës gjatë sundimit osman ishte në përbërje të vilajetit Vëllk, pastaj pjesë e sanxhakut të Vushtrrisë dhe më në fund pjesë e vilajetit të Kosovës, deri në vitin 1912. Deri në vitin 1959 territori copëtohet në disa rrethe e banovina, ndërsa nga ky vit bëhet komunë, me një territor të madh prej 854 km² dhe popullsi 120,000 banorë. Në vitin 1988 nga Prishtina u ndanë tri komuna: Fushë-Kosova, Obiliqi dhe Novobërda. Sot komunën e Prishtinës e përbëjnë 32 bashkësi lokale, prej të cilave 15 janë në qytet, ndërsa numri i vendbanimeve bashkë me qytetin e Prishtinës është 44.

Rritja e numrit të popullsisë së komunës ishte shumë dinamike, sidomos pas Luftës së Dytë Botërore, kur Prishtina bëhet kryeqytet i Kosovës. Në vitin 1961 komuna e Prishtinës kishte 102,500 banorë, në vitin 1981 kishte 210,000 banorë, në vitin 1991 me 295,000 banorë, ndërsa sot ka rreth gjysmë milioni banorë. Bazën ekonomike tani e përbëjnë industria dhe bizneset tregtare, kurse bujqësia ka pjesëmarrje të vogël, me më pak se 10%. Përveç objekteve industriale të përqendruara në qytetin e Prishtinës, janë edhe disa rafineri të plumbit dhe të zinkut në Hajvali dhe Kishnicë. Aglomeracioni urban i Prishtinës shtrihet në zonën e kontaktit të njëjve tektonike dhe morfologjike, të cilat janë reflektuar në procese të ndërlikuara natyrore, por edhe në lidhje komunikuese, në zhvillim ekonomik, kulturor dhe politik gjatë gjithë historisë. Në këtë zonë, për shkak të pozitës shumë të përshtatshme dhe terrenit të volitshëm, është koncentruar pjesa më e madhe e popullsisë së komunës, zhvillimi i hovshëm i veprimtarive ekonomike dhe joekonomike, infrastruktura etj. Kjo zonë është paraparë edhe me Planin hapësinor të Kosovës “Trekëndëshi i zhvillimit ekonomik të Kosovës” si bosht i zhvillimit me interes kombëtar. Këtë zhvillim strategjik e arsyeton lokacioni i qytetit të Prishtinës si kryeqendër e Kosovës, seli qeveritare e diplomatike, me korridoret kryesore të infrastrukturës rrugore, hekurudhore, ajrore, të telekomunikacionit dhe energjetikës, si dhe afërsia e kësaj hapësire me korridoret e rëndësishme europiane. (Ibrahim Ramadani)

PRISHTINA Hasan (1873-1933). Figurë e shquar e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, veprimtar i luftës për pavarësinë e Shqipërisë dhe për çlirimin e Kosovës. Lindi në Vushtri.



HASAN PRISHTINA

Mësimet e para (mejtëpin) dhe disa klasë të progjimnazit (iptida) i mbaroi në vendlindje. Kreu gimnazin francez në Selanik dhe shkollën e lartë të administratës “Mylkije” në Stamboll. U diplomua për drejtësi. U zgjodh tri herë deputet në parlamentin osman, ku u angazhua për të drejtat kombëtare të shqiptarëve (1908-1912). Ishte kundërshtari më i rreptë i politikës

antishqiptare të xhonturqve. Organizoi Mbledhjen e Taksimit më 12 janar 1912, ndërsa më pas, bashkë me Bajram Currin, Isa Boletinin dhe atdhetarë të tjerë ishte njëri nga organizatorët kryesorë të kryengritjes në Kosovë. Bashkë me Ismail Qemalin, në fillim të vitit 1912, ishte nismëtar i organizimit të kryengritjes së përgjithshme kundërosmane. U burgos nga serbët më 14 tetor të vitit 1912, me akuzë se cenonte interesat e Serbisë. Përkrahu shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë dhe ishte ministër në Qeverinë e Përkohshme të Vlorës. Në shtator të vitit 1913 organizoi kryengritjen antiserbe. Bashkë me Ismail Qemalin mbante lidhje me personalitetet të rëndësishme diplomatike, sidomos të Britanisë së Madhe, të Austro-Hungarisë dhe Italisë. Në vitin 1914 mbështeti qeverinë e Princ Vidit, duke u bërë për disa muaj ministër në qeverinë e Turhan Pashë Permetit. Ndhmoi në mbrojtjen e kryeqytetit të Durrësit, kur shpërtheu kryengritja e Shqipërisë së Mesme, ndërsa një vit më vonë organizoi rezistencën në Kosovë kundër pushtimit serb e malazez. Gjatë viteve 1916-1918 bashkëpunoi me autoritetet austriake, duke shpresuar se me mbështetjen e Austro-Hungarisë do të bëhej çlirimi dhe bashkimi përfundimtar i Kosovës me Shqipërinë. Më 1918, bashkë me Hoxhë Kadri Prishtinën, Bajram Currin dhe atdhetarë të tjerë themeloi Komitetin “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”. Pas Luftës së Parë Botërore, me rënien e Kosovës nën pushtimin serb, migroi në Vjenë dhe më pas në Romë. Aty hyri në lidhje edhe me kundërshtarët sllavë të formimit të Mbretërisë së Jugosllavisë, nga Kroacia, Mali i Zi dhe Maqedonia. Në dhjetor të vitit 1919 u vu në krye të delegacionit të Komitetit “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës” në Konferencën e Paqes në Paris, për të kërkuar bashkimin e Kosovës me shtetin shqiptar. Në prill të vitit 1921 u zgjodh deputet i Dibrës në Këshillin Kombëtar, ndërsa gjatë krizës politike të dhjetorit (më 7 dhjetor) u ngarkua nga Këshilli i Lartë të formonte qeverinë, por dha dorëheqjen (më 12 dhjetor), në interes të stabilitetit të vendit. Përgjatë viteve 1922-1923 zhvilloi një aktivitet të dendur politik opozitar, duke u bërë njëra nga figurat më të rëndësishme të skenës politike në Shqipëri. Për t’u shpëtuar ndjekjeve të qeverisë së Zogut, u strehua në Zonën Neutrale të Junikut. Gjatë vitit 1924, krahas organizimit të çetave të kaçakëve në

Kosovë, ishte pjesëmarrës aktiv në përgatitjet në Shqipëri të Kryengritjes së Qershorit, i cili solli në pushtet qeverinë e Fan Nolit. Pas fitores së kryengritësve, në qershor u kthye në Tiranë dhe më pas shoqëroi Nolin në Lidhjen e Kombeve, ndonëse ndër vendimet e para të qeverisë së Nolit ishte ndalja e punës së Komitetit “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”. Në periudhën 1925-1933, Hasan Prishtina vazhdoi aktivitetin për të sensibilizuar opinionin e gjerë, forumet ndërkombëtare dhe kancelaritë e shteteve vendimmarrëse për çështjen e Kosovës. Ai mbështeste pikëpamjen se problemi i Kosovës mund të zgjidhej me ardhjen në Shqipëri të një qeverie dhe të një klase politike me orientim të qartë kombëtar dhe me qëndrim të drejtë rreth çështjes së Kosovës. Me këtë qëllim u përfshi edhe në organizime të fshehta, siç ishte organizata “Bashkimi Kombëtar”, e cila përgatiti atentatin kundër Ahmet Zogut në Vjenë më 1931. H. Prishtina gjatë tërë jetës u ndoq nga vrasës dhe persekutorë. Ndaj tij u organizuan katër atentate, u burgos dy herë nga serbët e bullgarët dhe u dënua gjashtë herë me vdekje (nga xhonturqit, nga E. Toptani, nga Serbia dhe tri herë nga qeveria e Zogut). H. Prishtina ishte mbështetës i shkollës shqipe dhe i arsimit kombëtar. Përkrahu idenë që gjuha shqipe duhet të shkruhej me shkronja latine. Kontribuoi për mbajtjen e Kongresit të Manastirit (1908), ndihmoi hapjen e Normales së Elbasanit (1909) dhe u angazhua të dërgoheshin në këtë shkollë djem nga Dibra dhe Kosova. Shkroi edhe një numër të madh artikujsh publicistikë në shumë gazeta dhe revista të Shqipërisë dhe të kolonive shqiptare. Në vitin 1921 në Shkodër botoi veprën “Nji shkurtim kujtimesh mbi kryengritjen shqiptare të vjetit 1912”, që është njëra nga veprat më të rëndësishme të memoaristikës shqiptare. U vra më 14 gusht 1933 në Selanik. Për vrasjen e tij u akuzua Zogu dhe qeveria jugosllave. Në vitin 1977 eshtrat e H. Prishtinës u sollën në Shqipëri dhe u rivarrosën në Kukës. (Frashër Demaj)

PRISHTINA Hysen (?-1831). Poet, myfti, myderriz, kaligrafist, bibliofil, personalitet i shquar. Jetoj dhe veptoi në Prishtinë. Krahas punës së myftiut të qytetit, ka punuar edhe myderriz në Medresenë “Pirinaz”. Është autor i disa “nazireve” (gjini në letërsinë e divanit gjatë shekujve XIII-XIX). Hysen Efendi ishte emër i

njohur në qarqet intelektuale të kohës jo vetëm si poet, por edhe si dijetar dhe autoritet fetar. Ishte personalitet me ndikim edhe në zhvillimet shoqërore politike të asaj kohe. Luajti rol me rëndësi në jetën intelektuale dhe kulturore të Prishtinës dhe më gjerë. Bibliotekën e tij në Prishtinë e themeloi në dekadat e fundit të shekullit XVIII. Ishte bibliofil i madh. Vetëm në koleksionin e dorëshkrimeve të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, në Arkivin e Kosovës, në Bibliotekën e Bashkësisë Islame të Kosovës në Prishtinë ruhen mbi 50 vëllime të veprave të dorëshkruara nga fusha të ndryshme. Në të gjitha këto dorëshkrime, Hysen Efendiu ka vënë ose vulën e tij personale, ose vulën e bibliotekës së tij, ose, së bashku me to, edhe ndonjë shënim tjetër. Në to ka shumë shënime, komente dhe plotësime që ka bërë vetë Hysen Efendiu. Vdiq në Prishtinë dhe u varros në oborrin e Xhamisë "Alaudin". (Sadik Mehmeti)

PRISHTINA Hysen (1916-1991). Prefekt i Prishtinës gjatë Luftës së Dytë Botërore. Lindi në Prishtinë. Ishte i biri i Xhemajl Prishtinës. Shkollën fillore e filloi në Prishtinë, kurse dy vjetët e fundit i kreu në Tiranë. Studimet për agronomi i kreu në Romë. Më 1941 kthehet me familje në vendlindje. Në fillim të vitit 1942 u zgjodh prefekt i Prishtinës. U angazhua që Prishtinës orientale t'i jepte pamje perëndimore.



HYSEN PRISHTINA

Gjatë qeverisjes së tij, arsimit fillor dhe ai i mesëm mori zhvillim të shpejtë. Me iniciativën e tij emrat sllavë të rrugëve dhe shesheve të Prishtinës u zëvendësuan me emra shqip. Njihet edhe për faktin se urdhëroi institucionet shtetërore dhe ato private të ngrehnin flamurin kombëtar me rastin e 28 Nëntorit. Më 1942, në ditën e Bajramit të Madh, me porosi të tij në të gjitha xhamitë e Prefekturës flamuri i kalifatit u zëvendësua me flamurin kombëtar. Ai gjithashtu i mori në mbrojtje familjet hebraike në Prefekturën e Prishtinës. Për shkak se përkrahu manifestimet e prishtinasve për liritë dhe të drejtat e shqiptarëve, më 1943 u pezullua nga detyra e prefektit. Bashkëpunoi me Fuad Dibrën, Xhafer Devën, Ibrahim Lutfiun për organizimin e forcave ushtarake për mbrojtjen e

trojeve etnike. Përkrahu formimin e Lidhjes së Dytë të Prizrenit dhe u angazhua për krijimin e ushtrisë kombëtare dhe kundër pjesëmarrjes së të rinjve në ushtrinë gjermane dhe në njësitet partizane. Për këto veprime arrestohet në maj 1944 nga gjermanët, por pas revoltës së qytetarëve lirohet me kusht që të largohet nga Prishtina. Pas fitores së komunizmit, në fund të Luftës së Dytë Botërore emigroi në Itali, më pas në Turqi, Belgjikë e Kanada. Në emigracion veprimtarinë politike e zhvillon në kuadër të Lëvizjes së Legalitetit. (Fehmi Rexhepi)

PRISHTINA Kadri (Hoxhë Kadria) (1878-1925). Atdhetar, jurist, titullar i fesë, luftëtar i lëvizjes për bashkim kombëtar. Lindi në Prishtinë, ku kreu mësimet fillore në gjuhën



KADRI PRISHTINA

turke. Shkollën e mesme e kreu në Shkup dhe më pas i vijoi studimet në Stamboll për drejtësi, pedagogji dhe teologji, duke fituar në moshë të re titullin profesor në jurisprudencë dhe hoxhë në teologji. Në vitin 1902 iu bashkua lëvizjes xhonturke, më 1904 u arrestua, duke vuajtur 4 vjet burg. Në burg u sëmur dhe humbi njëren këmbë nga gangrena. Me përfundimin e dënimit, internohet në Tokat (verilindje të Antalias), ku punoi si këshilltar juridik. Pas revolucionit xhonturk, në vitin 1908 u vendos në Samsun, ku vijoi punën si avokat. Më 1913 filloi të punojë këshilltar ligjor në Bankën e Stambollit, ndërsa një vit më vonë vendoset në Shkodër, ku ushtroi profesionin e avokatit. Në të njëjtën kohë u angazhua për ruajtjen e tërësisë territoriale të Shqipërisë dhe bashkimin e trojeve shqiptare. Më 1915 krijoi "Komitetin e fshehtë", me një program nacionalist. Në bashkëpunim me Bajram Currin, Hasan Prishtinën etj., zhvilloi veprimtari të gjerë për mbrojtjen e të drejtave kombëtare të popullsisë shqiptare të Kosovës. Në nëntor të vitit 1918 ishte njëri nga themeluesit e komitetit "Mbrojtja Kombëtare e Kosovës". Si lider i kësaj organizate u angazhua brenda dhe jashtë vendit për çlirimin e Kosovës dhe konsolidimin e shtetit të pavarur shqiptar. Ishte pjesëmarrës në Kongresin e Lushnjës dhe në qeverinë e Sylejman Delvinës, të dalë prej tij, u caktua ministër i Drejtësisë. Në emër të

qeverisë së re udhëhoqi bisedimet me palën italiane për tërheqjen e tyre nga pretendimet “mbikëqyrëse” ndaj Shqipërisë. U angazhua për shtrirjen e autoritetit të qeverisë së re në Shkodër dhe në rajone të tjera të Shqipërisë. Në qeverinë jetëshkurtër të Hasan Prishtinës, në dhjetor të vitit 1921, sërish u emërua ministër i Drejtësisë. Në periudhën 1921-1923 u zgjodh deputet dhe nënkryetar i Këshillit Kombëtar (Parlamentit), si përfaqësues i Dibrës dhe anëtar i Komisionit të Drejtësisë, ndërsa në zgjedhjet e vitit 1924 si përfaqësues i Prefekturës së Kosovës. Ishte kryetar i Partisë Përparimtare, parti opozitare, duke u bërë njëra nga figurat e shquara të lëvizjes demokratike shqiptare dhe kundërshtar i Ahmet Zogut. Gjatë viteve 1922-1923 mërgoi në Austri dhe më pas u kthye përsëri në Shkodër. Muajt e fundit të vitit 1923 botoi revistën politike-letrare-fetare “Udha e s’vërtetës”. Si jurist dha ndihmesë të çmuar për zgjerimin e Statusit të Lushnjës dhe ishte ndër të parët që vuri themelet e jurisprudencës shqiptare. Si teolog, fenë e trajtonte si element bashkimi. Vdiq në Shkodër. (Endrit Musaj)

PRISHTINA Nuri Begzade (shek. XVIII-XIX). Poet, autor i një divani. Nuk ka të dhëna të sakta për vitin e lindjes dhe të vdekjes së tij. Sipas disa burimeve, supozohet se vdiq para vitit 1831. Dihet se vendlindja e tij ishte Prishtina, se kishte një vajzë, Zylejhanë dhe një djalë, Ymer Sakipin. Pasi u largua nga Prishtina, u vendos në Stamboll. Kurrë nuk ishte pajtuar me fatin që e kishte lënë vendlindjen. Malli i tij për atdheun vërehet qartë në poezitë e tij. Në divanin e tij 27 herë i këndon vendlindjes së tij, Prishtinës. Vdiq në Stamboll. (Irfan Morina)

PRISHTINA Pir Mehmet (shek. XV-XVI). Poet dhe shkencëtar nga Prishtina. Në Arkivin e Kosovës ruhet një vepër e këtij autori nga fusha e gjuhësisë arabe, me titull “Qetësia e Zemrave (koment)”. Vepra ka 330 faqe dhe është shkruar në vitin 1559, kurse është kopjuar në vitin 1561 nga një tjetër intelektual i Prishtinës, Ahmet Mehmeti. Dorëshkrimi është lënë vakëf nga vetë autori, i cili kërkon që ai të lejohet të kopjohet nga kushdo që dëshiron ta bëjë këtë, askush të mos pengohet për shfrytëzimin e tij, të ruhet nga humbja dhe keqpërdorimi dhe të mos dalë jashtë qytetit të Prishtinës. Mbikëqyrja e dorëshkrimit po nga autori i është lënë “atij që do të jetë imam në Xhaminë

e Vjetër (Xhamia e Çarshisë), që gjendet në Prishtinë”. Në dorëshkrim gjendet edhe një shënim në gjuhën osmane, i shkruar nga një person i mëvonshëm, në të cilin përshkruhen vështirësitë për ruajtjen e kësaj vepre gjatë kohës së pushtimit austriak të Prishtinës (1689-1690), kur një pjesë e banorëve të saj qe detyruar të shpërngulej, e së bashku me ta edhe ky dorëshkrim, duke përfunduar në Serez (sot Greqi), ku u vendos një pjesë e popullatës së Prishtinës. Dorëshkrimi mbeti në Serez për afro një shekull e gjysmë derisa disa tregtarë u angazhuan dhe më 1844 këtë dorëshkrim ia kthyen qytetit. Në vitin 1860 dorëshkrimi u dorëzua në bibliotekën e Medresesë së Prishtinës. (Sadik Mehmeti)

PRISHTINA Zija (shek. XIX). Veprimtar i lëvizjes kombëtare, anëtar i Komitetit të Stambollit së bashku me vëllanë e tij Ali Danish Prishtina. Pas shpalljes së traktatit të Shën Stefanit u angazhua për mbrojtjen e trevave shqiptare dhe për formimin e vilajetit autonom shqiptar. Që nga themelimi i Lidhjes së Prizrenit ishte njëri ndër udhëheqësit e saj. U zgjodh anëtar i Komitetit Kombëtar të Lidhjes, anëtar i komisionit financiar, që kryesohej nga Sulejman Vokshi. Dega e Lidhjes Shqiptare në Prishtinë u formua me iniciativën e tij. Kjo degë, në krye me Z. Prishtinën kundërshtuan dorëzimin e Plavës dhe Gucisë Malit të Zi. Në Prishtinë, në kryeqytetin e vilajetit të Kosovës, u zhvillua një mbledhje, nën drejtimin e Ymer Prizrenit dhe Zija Prishtinës, në të cilën morën pjesë rreth 800 veta, të ardhur nga viset e ndryshme të sanxhakut të Prishtinës. Më 7 maj të vitit 1879, Zija Prishtina i paraqiti Portës së Lartë petitionin e popullsisë së sanxhakut të Prishtinës, në të cilin kërkohej të mos bënte asnjë lëshim të trojeve shqiptar. Pas shtypjes së Lidhjes, si një nga udhëheqësit e saj, u dënua me burg dhe internim. (Luan Tetaj)

PRIVATIZIMI. Është transferimi i pronës shoqërore ose shtetërore në pronë private. Edhe pse si fenomen mund të gjurmohet shumë herët në historinë botërore, privatizimi si koncept modern daton nga vitet ‘80 të shekullit të kaluar, pas reformave të ndërmarra për transferimin e pronës në Britani të Madhe. Pas kësaj periudhe, vende të zhvilluara dhe në zhvillim kanë përdorur, në masë të ndryshme, privatizimin si mjet për të reformuar sektorin

shoqëror apo shtetëror. Kjo reformë kryesisht është frymëzuar nga afarizmi i dobët i sektorit shoqëror apo shtetëror në këto vende. Ish-vendet socialiste, ku pronësia shtetërore dhe shoqërore ishte dominuese, kanë filluar procesin e privatizimit në fillim të viteve '90. Në këto vende procesi i privatizimit ishte pjesë e reformave të tjera të kalimit nga ekonomia e centralizuar në atë të tregut. Kosova është vendi i fundit nga ish-blloku i Europës Lindore, i cili ka filluar procesin e privatizimit në një shkallë të gjerë. Ndonëse privatizimi në Kosovë ka filluar në vitin 1989, në bazë të ligjit mbi kapitalin shoqëror, numri i kompanive që kanë kaluar nëpër këtë proces atëbotë ka qenë shumë i vogël, kryesisht nga rajoni i Gjakovës. Në atë kohë procesi i privatizimit ishte ndërprerë shumë shpejt për shkak të fillimit të masave të dhunshme, që pasuan pas suprimimit të autonomisë së Kosovës në vitin 1989. Pas vitit 1999, UNMIK-u ka filluar procesin e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore në vitin 2002. Procesi i privatizimit në Kosovë ka trashëguar mbi 500 ndërmarrje shoqërore, privatizimi i të cilave është bërë duke përdorur çmimin më të lartë si kriter të shitjes (në rastin e privatizimit përmes spin off-it të rregullt dhe likuidimit, çmimi më i lartë ka qenë kriteri i vetëm; ndërsa në rastin e spin off-it special ky kriter është përcjellë edhe me obligime të tjera lidhur me nivelin e punësimit dhe investimeve). Nga të ardhurat e akumuluar, 20% u janë ndarë punëtorëve, ndërsa nga pjesa tjetër fillimisht janë trajtuar detyrimet legjitime të ndërmarrjeve shoqërore, ndërsa pjesa e mbetur është kthyer në buxhetin e Kosovës. Për shkak të vonësive në trajtimin e kërkesave të kreditorëve legjitimë, të ardhurat nga shitja ende mbahen në llogari mirëbesimi jashtë aktivitetit ekonomik. Privatizimi i ndërmarrjeve publike qendrore, në anën tjetër, ka filluar pas pavarësimit të vendit në vitin 2008, kur këto ndërmarrje janë transferuar në pronësi të plotë të Qeverisë së Kosovës. (Alban Hashani)

PRIZRENCI (Priesrienaç, Presrenereç). Qytet dhe fortifikatë mesjetare. Shtrihet në pjesën veriore të lagjes së Hoxhajve, 5 km në veriperëndim të fshatit Bresalc. Kalaja është e vendosur në kodrinën e fshatit, ndërmjet Gradinës dhe Kulinës. Për herë të parë Prizreni përmendet vetëm nga fillimi i shekullit XV

(1412), si fortifikatë, me vendbanim dhe shesh (*castrus, locum, forum*), ku qëndruan raguzanët. Në vitin 1427 e përmendin tregtarët raguzanë së bashku me Novobërdën, që u pushtua nga osmanët në vitin 1455.

Qyteti-fortifikatë shtrihet në një majë me pyllëzim të dendur, mbi një kodrinë që dominon mbi rrethinën, rreth 12 km në jugperëndim të Novobërdës. Pjesa kryesore, tetrapirgu, ka dy kulla të plota anësore dhe një të hapur në mes. Fortifikata është e rrënuar plotësisht, mirëpo në bazë të vëzhgimeve në terren ende i ka të dukshme muret jugore, lindore dhe perëndimore. Muret e fortifikatës i bashkon pika më e lartë strategjike 900 m. Në hapësirën mes murit të parë dhe të dytë rrethues, sidomos në pjesën jugperëndimore, ndodhen themele të shumta të ndërtesave, kthinave. E tërë hapësira është e rrethuar me mure të trasha. Në disa vende muret janë dëmtuar nga gërmuesit klandestinë me eskavatorë. Në murin e dytë rrethues ka tri vrojtimore. Fortifikata duket se ka pasur komunikim të gjerë me të gjitha fortifikimet e rajonit, sidomos me Novobërdën, me fortifikimet në malësinë e Zhegocit, si dhe me fortifikimet e Karadakut. Në bazë të analogjisë së materialit ndërtimor, fortifikata ka fazën e antikitetit në pjesën jugore, ndërsa ndërtimet gjatë periudhës bizantine kanë lënë gjurmë në të gjitha pjesët e tjera të saj. Muret e trasha janë ndërtuar me stil mesjetar. Në pjesën më jugore të fortifikatës gjenden edhe mbetjet e një ndërtese me tulla dhe gurë, e cila duket të jetë monument kulti. (Faik Sahiti)

PRIZRENI. Qyteti i dytë për nga madhësia në Kosovë dhe qendër e komunës me të njëjtin emër. Është qendër rajonale e Dukagjinit Jugor me komunat përreth: Rahovec, Suharekë, Sharr.



PRIZRENI

Shtrihet në pjesën jugore të Kosovës, rrëzë maleve të Sharrit, në të dy anët e Lumëbardhit. Edhe pse i mbyllur me reliev malor, luginat lumore i mundësojnë lidhje të mira me viset e tjera. Nëpërmjet luginës së Drinit të Bardhë në perëndim lidhet me bregdetin Adriatik, përmes luginës së Bisticës lidhet me qendrën turistike të Brezovicës, pastaj me Ferizajn dhe Shkupin, ndërsa në anën tjetër, i hapur ndaj Rrafshit të Dukagjinit, ka lidhje të mira me Gjakovën dhe Pejë, por edhe me Podgoricën. Përmes Qafës së Duhlës në veri lidhet me Prishtinën dhe më tej me Europën Qendrore.

Prizreni është njëra ndër qendrat më të vjetra të Kosovës. Në lokalitetin e Prizrenit janë gjetur shumë gjurmë nga koha e sundimit romak, si mbishkrime në gjuhën latine, materiale arkeologjike, ndërsa kalaja paraqet pjesën më të vjetër të qytetit. Kalaja u ndërtua në shekullin XI. Në dokumentet e shkruara përmendet Ipeshkvia e Prizrenit, e ndërtuar në vitin 1020. Me emrin Prisdrina përmendet në kartën e mbretit bizantin Vasilit II më 1019 dhe në kartën e Stefan Nemanjës të vitit 1198. Në vitin 1204 Prizreni bie nën sundimin bullgar, kurse në vitin 1282 bie nën sundimin serb. Dokumentet flasin edhe për zotërimin e Prizrenit nga Gjon Kastrioti, që lidh marrëveshje me Dubrovnikun në vitin 1420, i cili mbronte tregtarët raguzanë brenda territorit të tij që nga bregdeti deri në Prizren. Në mesjetë në Prizren mbaheshin panairë të mëdha, gjë që dëshmon se qyteti kishte ekonomi të zhvilluar, me degët e bujqësisë, tregtisë dhe prodhimeve zejtare. Për afirmimin e kësaj qendre transite ndërmjet brendisë së Gadishullit Ballkanik dhe të detit Adriatik rol të rëndësishëm pati tregtia e zhvilluar në rrugën Naissus-Lissum (Nish-Lezhë). Prizreni në vitin 1455 bie nën sundimin e gjatë të Perandorisë Osmane. Në këtë periudhë qyteti fillon ta ndryshojë fizionominë e tij urbane. Në vitin 1570 Prizreni merr funksionin e qendrës së sanxhakut. Me këtë vërehet përparimi ekonomik dhe zgjerimi i shpejtë territorial i tij me karakteristika orientale. Gjatë tërë periudhës osmane, Prizreni përmendet si qendër e rëndësishme ekonomike, kulturore dhe administrative e Kosovës, ku ishin të vendosura shumë konsullata të vendeve të ndryshme, si të Austrisë, të Anglisë, të Italisë, të Rusisë etj. Në shek. XVII Prizreni ishte ndër qytetet më të mëdha të Gadishullit Ballkanik, si dhe qendër e rëndësishme ekonomike për

prodhimet blegtorale, zejtare, dhe të armëve (pushkëve dhe shpatave). Në fizionominë e qytetit dominonin rrugët e ngushta dhe të përdredhura, të cilat ndanin qytetin në lagje dhe në çarshi. Aktivitetet e shumta afariste, tregtare dhe zejtare ishin të lidhura me çarshinë, si hapësira të veçanta, që dallonin nga pjesët e tjera të qytetit. Në shek. XIX Prizreni kishte 31 lagje dhe 4 çarshi. Dyqanet ishin të përqendruara sipas llojit të zejeve në çarshi të posaçme. Kështu, në çarshinë Arasta kanë qenë të vendosur saraçët, kazanxhinjtë etj., kurse në çarshinë e Shatërvanit, argjendarët, pushkaxhinjtë etj. Pas Luftës së Dytë Botërore çarshia Arasta u rrënuar, ndërsa në lokacionin e saj u ndërtuan objekte të reja me funksione publike. Me këtë u dëmtua dukshëm trashëgimia kulturore dhe origjinaliteti i qytetit. Prizreni njihet me objekte të shumta kulturore-historike, si: Kalaja e ndërtuar në mesjetë, Kisha e Levishkës e shek. XIV, pastaj Manastiri i Shën Arhangelit dhe disa ura me vlerë historike. Nga monumentet e shumta të kulturës orientale dallohen Xhamia e Sinan Pashës, Xhamia e Gazi Mehmet Pashës, Hamami i Qytetit, i ndërtuar nga Mehmet Pasha, medresetë, teqetë, objektet e banimit të tipit oriental etj. Përballë kalasë së voni u ndërtua kompleksi i Lidhjes së Prizrenit, ku në vitin 1878 u mbajt mbledhja historike e kësaj Lidhjeje, e njohur si simbol i rezistencës shqiptare për pavarësi.

Për lashtësinë dhe rëndësinë e Prizrenit flasin shumë dokumente të shkruara nga misionarë të ndryshëm. Sipas Marin Bicit, Prizreni në vitin 1610 kishte 8,600 shtëpi, kurse sipas Pjetër Mazrreikut, në vitin 1623 Prizreni kishte 12,000 banorë, shumica shqiptarë. Udhëpërshkruesi J. Miller bën të ditur se Prizreni në vitin 1838 kishte 25,000 banorë. Në raportin e konsullit austriak në Shkodër të vitit 1858 është shkruar se Prizreni kishte 25,000 banorë, nga të cilët 20,000 ishin shqiptarë, ndërsa sipas konsullit frëng në Shkodër, në vitet '60 të shek. XIX, Prizreni kishte 46,000 banorë. Shifra të përafërta të numrit të banorëve jepen edhe në sallnamen e vilajetit të Prizrenit të vitit 1876, ku saktësohet se në këtë qytet jetonin 43,922 banorë, nga të cilët 35,622 myslimanë dhe 8,300 të tjerë.

Në vitin 1912 Prizreni okupohet nga serbët dhe me këtë nisi një periudhë e rëndë për popullsinë e këtij qyteti. Shumë familje shqiptare u shpërngulën, sidomos familjet e pasura dhe

intelektualë të shumtë, ndërsa në vend të tyre u vendosën kolonët serbë. Kjo gjendje e vështirë zgjati rreth katër dekada. Sipas regjistrimit të vitit 1921, Prizreni kishte 16,487 banorë, në vitin 1931 kishte 18,955 banorë, kurse në vitin 1981 kishte 62,000 banorë. Pas Luftës së Dytë Botërore, Prizreni përjetoi një ndryshim dhe zhvillim të gjithanshëm ekonomiko-shoqëror, duke ndryshuar pamjen e tij. U ndërtaun shumë kombine dhe komplekse industriale, qendra shëndetësore, objekte të arsimit e të kulturës, objekte të banimit, rrugë të reja, zona tregtare, të cilat ndikuan jo vetëm në zgjerimin territorial të qytetit, por edhe në fizionominë bashkëkohore. Kështu, Prizreni bëhet qendër e madhe industriale me profile të ndryshme, siç është ajo e tekstilit, ushqimore, e këpuçëve, metalike, farmaceutike etj. Në bazë të funksioneve të kategorisë së lartë, Prizreni bëhet qendër atraktive për një pjesë të madhe të territorit të Kosovës dhe jashtë saj. Nga veprimtaritë terciare dallon funksioni i komunikacionit, ai tregtar dhe shumë institucione të karakterit publik. Prizreni njihej si qendër e arsimit edhe më herët, duke zhvilluar një rrjet të gjerë të shkollave të mesme. Ndërkohë në Prizren themelohet Shkolla e Lartë Pedagogjike, ndërsa tani është edhe qendër e rëndësishme universitare. Sot në qytetin e Prizrenit jetojnë rreth 100,000 banorë. (Ibrahim Ramadani)

PRIZRENI (komuna). Komunë në pjesën jugore të Kosovës, me qendër qytetin me të njëjtin emër. Sipërfaqja e komunës është 627 km², numri i popullsisë sipas regjistrimit të vitit 2011 është 177,781, me dendësi mesatare prej 283,5 b/km², kurse numri i vendbanimeve është 76. Në lindje kufizohet me komunën e Suharekës dhe të Shtërpcës, në veri dhe veriperëndim me komunën e Rahovecit dhe të Gjakovës dhe në jug me komunën e Dragashit. Prizreni është qendër rajonale e Dukagjinit Jugor, që përfshin territorin prej 1,909 km² dhe komunat që gravitojnë në të: Suhareka, Rahoveci, Dragashi dhe Mamusha.

Morfologjinë e relievit e përcaktojnë dy tërësi kryesore: Mali i Sharrit dhe fusha e Prizrenit, me rrjedhën e poshtme të Drinit të Bardhë. Mali i Sharrit shtrihet ndërmjet fushës së Pollogut dhe asaj të Prizrenit, në drejtim jugperëndim-verilindje. Ky kompleks malor bëhet pengesë e depërtimit të erërave të nxehta të jugut, ndërsa

në anën tjetër, fusha e gjerë e Dukagjinit është e hapur ndaj masave të ftohta të veriut. Në anën lindore territorin e komunës e mbyllin malet e Jezercit dhe të Nerodimes, ndërsa në anën perëndimore malet e Pashtrikut dhe të Koritnikut. Fusha e Prizrenit shtrihet në formë të zgjatur, në drejtim juglindje-veriperëndim, në lartësi mbidetare 300-400 m. Rrjedhjet e shumta lumore në drejtim të kësaj fushe kanë krijuar rrafshinat aluviale, të kombinuara me tarracat liqenore. Klima është e mesme kontinentale, me ndikim të rrymave të ngrohta nga perëndimi, që depërtojnë nëpërmjet luginës së Drinit të Bardhë. Temperatura mesatare e dimrit është 1.4^o C (e janarit 0.1^o C), e pranverës 10.5^o C, e verës 20.8^o C (e korrikut 22.8^o C) dhe e vjeshtës, 12.0^o C. Vlera absolute maksimale e temperaturës në verë është 38.1^o C dhe minimale absolute në dimër -18.4^o C, ndërsa sasia mesatare vjetore e reshjeve është 797 mm. Më së shumti reshje bien gjatë vjeshtës dhe dimrit, që është karakteristikë e tipit të klimës maritime. Reshje më të shumta bien në masivet malore, mbi 100 mm më shumë se në viset e ulëta fushore. Kjo ndikon dukshëm në gjallërimin e lumenjve, që rrjedhin nëpër territorin e komunës. Erërat në komunën e Prizrenit ndikohen dukshëm nga relievi. Pozita gjeografike e komunës, me reliev të rrafshët fushor në veri dhe me pengesa malore në jug, kushtëzojnë rastisjen e drejtimeve kryesore të erërave. Prej erërave kontinentale dallohet ajo verilindore me rastiçe prej 14.0%, sidomos gjatë shkurtit dhe marsit, ndërsa prej erërave maritime dallon ajo jugperëndimore me 16.6%, që shprehet më së shumti gjatë prillit me 22.6% dhe në muajin maj me 21.1%, kur bie edhe maksimumi i dytë i reshjeve. Rrjeti hidrografik është mjaft i dendur dhe në tërësi i takon ujëmbledhësit të Drinit të Bardhë, përkatësisht pellgut të detit Adriatik. Lumi kryesor është Lumëbardhi, degë e majtë e Drinit të Bardhë. Është shumë i rëndësishëm për ujitjen e tokave të fushës së Prizrenit. Buron në malet e Sharrit, në lartësi 2,360 m, ndërsa derdhet në Drinin e Bardhë, në lartësi mbidetare 283 m, me gjatësi prej 35 km. Degët kryesore të Lumëbardhit janë: lumi i Manastirit (12 km), Korisha (21 km), lumi i Berishës (11 km), Shartica (6 km), Petershnica (6 km), lumi i Drajçiqit (3.3 km) dhe i Thanasit (Jabllanicës) (3 km), kurse në anën e djathtë rrjedh lumi i Pllajës me gjatësi 5 km. Pjesa më e madhe e territorit të komunës është

e mbuluar me pyje, me rreth 35%, sipërfaqe me ara janë 27%, ndërsa pjesa tjetër është me kullosa dhe livadhe. Nga kulturat bujqësore më shumë mbillen drithërat dhe perimet. Në periudhën pas Luftës së Dytë Botërore u bë ndërtimi i rrjetit të ri të ujitjes dhe rindërtimi i rrjetit të vjetër. Në komunën e Prizrenit sot ujitën 5,100 ha sipërfaqe të tokës, që është 20% nga sipërfaqja e tokës së punueshme, që i bie mbi mesataren e Kosovës.

Nga ana ekonomike, Prizreni njihet si komunë industriale-agrare, në të cilën rreth gjysma e të ardhurave sigurohen nga industria dhe ndërtimtaria, kurse pjesa tjetër nga bujqësia, transporti, tregtia, turizmi dhe hoteleria. Qendra kryesore ekonomike është Prizreni, me industrinë e tekstilit, ushqimore, të këpucëve, farmaceutike etj. Tani, me liberalizimin e kufirit me Shqipërinë dhe me ndërtimin e autostradës Prishtinë-Durrës, për Prizrenin hapet një perspektivë e re e zhvillimit të gjithëmbarshtëm shoqëror dhe ekonomik. (Ibrahim Ramadani)

PRIZRENI Hafiz Mehmet-Emin (1852-1909). Myderriz, myfti dhe deputet në Parlamentin Osman. Pasi mbaroi mësimet e para në mejtepin e Sejdi Beut, shkollimin e vazhdoi në Medresenë e Emin Pashës dhe në Ruzhdijen e Prizrenit. Që në moshën nëntëmbëdhjetëvjeçare iu besua detyra e imamit në Xhaminë e Emin Pashës. U diplomua në vitin 1879. Një kohë punoi si praktikant në Gjykatën e Prizrenit, më pas u emërua myderriz dhe një vit më vonë (1884) myfti i Prizrenit. Nga Komiteti Qendror i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit u emërua redaktor dhe drejtor i gazetës "Ittihad" ("Bashkimi"), që parashihej të dilte si organ i Qeverisë së Lidhjes Shqiptare. Në vitin 1908, pas shpalljes së Kushtetutës, u zgjodh deputet i Prizrenit në Parlamentin Osman, së bashku me Sherif Efendiun dhe me Jahja Agën. Ka lënë një vepër në dorëshkrim në gjuhën osmane. (Nehat Krasniqi)

PRIZRENI Osman Baba (?-1752). Sheh i dalluar halvetinj i krahut "jigitbashinj". Lindi në fshatin Velezhë të rrethit të Prizrenit në gjysmën e dytë të shek. XVII. Pas përfundimit të studimeve në Stamboll, vijoi mësimet nga fusha e misticizmit islam. Me të marrë diplomën për sheh, u kthye në Prizren në vitin 1713. Pas një kohe, në lagjen Saraçhane të Prizrenit, pranë Xhamisë së Mehmet Kukli

beut, ndërtoi teqenë e tij, e njohur si Teqeja e Saraçhanes. Punoi afro dyzet vjet në edukimin shpirtëror të ndjekësve të tij. Gjatë kësaj kohe ai përgatiti dhe promovoi dervishë e shehlerë të rinj në sanxhakun e Prizrenit dhe më gjerë. Teqeja e tij mbeti teqe qendrore për të gjitha teqetë e tarikatit halvetinj të këtyre anëve deri më sot. Vdiq në Prizren në vitin 1752 dhe u varros në tyrben e teqesë së tij. Edhe pasardhësit e tij në postin e shehut ishin njerëz të ditur dhe me ndikim në Prizren. Disa prej tyre ishin edhe poetë, ndërsa sheh Hysejni (vdiq më 1926) ka shkruar edhe poezi shqipe me alfabetin arab. (Nehat Krasniqi)

PRIZRENI Tahir efendi (?-1883). Myderriz, myfti, historian, epigrafist, poet në gjuhët orientale. Lindi në Prizren, ku edhe mori mësimet e para. Rrjedh nga oxhaku i Rotllajve. Studimet i mbaroi në Stamboll (1843). Pas mbarimit të studimeve u kthye në vendlindje dhe një kohë të gjatë punoi si myderriz në Medresenë e Emin Pashës. Në vitin 1865 u emërua myfti i sanxhakut të Prizrenit. Është autor i një kronike historike në vargje, në gjuhën arabe, "autografi". Kronika është burim i rëndësishëm informacionesh për jetëshkrimet e shumë personaliteteve vendëse, që janë dalluar në jetën fetare, arsimore, kulturore dhe politike gjatë shekujve XV-XIX. Tahir Efendiu është edhe autor i tri epigrafeve të ruajtura dhe autor i dy veprave të tjera në gjuhën osmane, të cilat ruhen në një bibliotekë private në Prizren. (Nehat Krasniqi)

PRIZRENI Ymer (1820-1887). Udhëheqës i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (LSHP). Lindi në Prizren. Shkollimin fillor dhe të mesëm i kreu në vendlindje, ndërsa në Stamboll studioi teologjinë, drejtësinë dhe filozofinë. Si deputet në parlamentin osman (1877) kritikoi qeverinë e paaftë për të mbrojtur trojet shqiptare nga kërcënimet e fqinjëve. Komiteti i Stambollit e autorizoi Y. Prizrenin të ftojë, në emër të Këshillit Organizativ, përfaqësuesit e të gjitha trojeve shqiptare për të themeluar LSHP-në (10 qershor 1878). Mbrojti idenë e autonomisë së Shqipërisë. Si kryetar i Kuvendit të Përgjithshëm



YMER PRIZRENI

të Lidhjes (1879), urdhëroi mobilizimin e forcave të saj për mbrojtjen e Plavës dhe të Gucisë (1879-1880). Iu bashkua krahut patriotik të LSHP-së, vazhdoi pastrimin e saj nga elementët osmanlinj, përfshirë edhe vëllanë e tij. Me nismën e tij, Kuvendi i Lidhjes kërkoi nga Sulltani bashkimin e Shqipërisë dhe caktimin e një personi që do të qeveriste në emër të tij në shtetin e ri. Mirëpo, Porta, pasi e zgjidhi çështjen e kufirit me Greqinë (27 mars 1881), iu kthye shtypjes së LSHP-së. Qeveria e Përkohshme me urdhër të kryetarit të saj, Y. Prizrenit dhe të Shuaip Spahiut (28 mars 1881), i ndërpreu lidhjet telegrafike të Kosovës me viset e tjera të Perandorisë. Shërbimin postar me viset shqiptare e kryenin korrierët. Y. Prizreni me bashkëpunëtorët organizoi forcat e Lidhjes kundër ekspeditës së Dervish Pashës në prill të vitit 1881 në Slivovë dhe Shtime. Ai u dërgoi ambasadorëve të Fuqive të Mëdha në Stamboll një telegram, ku kërkonte ndërmjetësimin e tyre për tërheqjen e ekspeditës kundër LSHP-së, ndërsa sulltani i dërgoi një memorandum (15 prill 1881), në të cilin fajësonte Qeverinë si shkaktare të rebelimit të shqiptarëve dhe bashkimit të tyre rreth LSHP-së, e cila luftonte me të drejtë për mbrojtjen e atdheut kundër fqinjëve agresorë dhe interesave të Fuqive të Mëdha. Kërkonte nga Sulltani që ta shikonte realisht rrezikun që po i kanosej ardhmërisë së popullit shqiptar. Në fund të memorandumit theksonte se po të zgjidhej drejt çështja shqiptare, atëherë ata do të ishin besnikë të sinqertë të tij. Por më 20 prill 1881 Dervish Pasha filloi sulmet kundër forcave të Lidhjes dhe më 22 prill hyri në Prizren. Dervish Pashës nuk iu nënshtruan vetëm Y. Prizreni, A. Frashëri, S. Vokshi dhe A. Ibra. Pas burgosjes së A. Frashërit, Y. Prizreni mërgoi në Ulqin. Dervish Pasha i dërgoi ftesa të njëpasnjëshme për t'u kthyer në vendlindje, për amnisti e favore të ndryshme, derisa, më në fund, ia internoi familjen. Mareshali osman druante se Y. Prizreni mund të kishte dokumente që do ta komprometonin Sulltanin, i cili kishte premtuar vilajetin autonom shqiptar. Në Ulqin përcillej hap pas hapi nga pushteti malazez. Pas një goditjeje në kokë nga një dorë e panjohur ndërroi jetë në Ulqin, ku u varros me nderime nga ulqinakët. (Masar Rizvanolli)

PROCESI I BOLONJËS (1999). Unifikim i arsimit të lartë në Europë, me synim zvogëlimin e dallimeve në sistemet e arsimit të

lartë në vende të ndryshme europiane dhe krijimin e “zonës së arsimit të lartë europian”. Zbatimi i kësaj marrëveshjeje në arsimin e lartë në Kosovë filloi në vitin akademik 2001/02 dhe u sanksionua me Ligjin mbi arsimin e lartë në Kosovë (2003). Sipas këtij ligji, sistemi i arsimit të lartë në Kosovë ka tri nivele: Niveli i parë me 3-4 vite studimi, studenti arrin 180, përkatësisht 240 ECTS (kredi) dhe merr diplomën baçelor; niveli i dytë, me 1-2 vite studimi, studenti arrin 60, përkatësisht 120 kredite dhe merr diplomën master; niveli i tretë, me studime 3-vjeçare të doktoratës me karakter akademik, aplikativ dhe kërkimor-shkencor. Në vitin 2004 në Kosovë u hartua edhe “Strategjia për zhvillimin e arsimit të lartë” në frymën e procesit të Bolonjës, duke përfshirë këtu të gjitha institucionet e arsimit të lartë. Në vitin 2005 në kuadër të Universitetit të Prishtinës u themelua edhe njësi për ECTS, u zgjodh koordinatori i saj dhe koordinatorët në të gjitha njësitë akademike të Universitetit. Për afirmimin e këtij procesi reformues, sipas modelit europian, në Kosovë më 2006 u formua “Grupi kosovar për promovimin e procesit të Bolonjës”, i cili hartoi edhe projektin “Promovimi i procesit të Bolonjës në Kosovë”. Në fund të vitit akademik 2006/07 Universiteti i Prishtinës nisi punën për konsolidimin e kurrikulave të ciklit të dytë (master) sipas Deklaratës së Bolonjës, për të vijuar me këtë proces edhe në vitet në vijim, me synim të përafrimit të standardeve të arsimit të lartë kosovar me standardet e arsimit të lartë europian. (Islam Krasniqi)

PROCESI I STABILIZIM-ASOCIMIT PËR KOSOVËN. Kornizë e politikave të BE-së ndaj Kosovës, me qëllim të integritit të Kosovës në BE. Si një segment i procesit të stabilizim-asocimit (PSA) ndaj Ballkanit Perëndimor, të përcaktuar në komunikatën e Komisionit Europian (maj 1999) dhe të konfirmuar nga Këshilli (qershor 1999), synon stabilizimin dhe transicionin drejt një ekonomie të lirë e konkurrenente të tregut, bashkëpunimin rajonal dhe perspektivën europiane të këtyre vendeve. Përderisa PSA-ja mbetet i vetmi shteg i paraparë për integrim të vendeve të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Europian (BE), pengesat politike për shumë vjet e vështirësuan jetësimin e tij në rastin e Kosovës, duke krijuar instrumente speciale. Kështu, në vitin 2002 ishte krijuar “Mekanizmi përcjellës i stabilizim-

asocimit”, me të cilin synohej të realizohet përmbajtja e procesit të stabilizim-asocimit, por duke mos paragjykuar statusin e ardhshëm të Kosovës. Përmes “dialogëve” (takimeve të natyrës politike të mbajtura tri herë në vit dhe atyre sektoriale të mbajtura së paku një herë në vit) ishte bërë e mundur për institucionet e Kosovës përfitimi i njohurive rreth standardeve europiane, si dhe harmonizimi i legjislationit me BE-në dhe forcimi i kapaciteteve të nevojshme administrative. Ky mekanizëm i PSA-së më vonë u shndërrua në dialogun e procesit të stabilizim-asocimit, me qasje të njëjtë në përmbajtje përkatësisht takime të nivelit politik dhe ato sektoriale (për reformë të administratës publike, drejtësi, liri dhe të drejta, çështje ekonomike, financiare e statistikore, tregti, dogana e taksa, tregti të brendshme, mbrojtje të konsumatorëve dhe shëndetësi, inovacione, shoqëri informative e politika sociale, transport, mjedis dhe zhvillim rajonal, bujqësi, peshkatar, pylltari dhe siguri të ushqimit, dialog me shoqërinë civile, programe të asistencës etj.). Dialogu i procesit të stabilizim-asocimit është dizajnuar si mekanizëm për këshillimin e institucioneve kosovare mbi masat që duhet të ndërmerren për zbatim të prioriteteve reformuese. Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, mungesa e unitetit brenda BE-së për statusin e Kosovës vështirësoi realizimin e fazave të rregullta në procesin e stabilizim-asocimit. Si rezultat i përpjekjeve të shumta për të gjetur gjuhë të përbashkët brenda BE-së, në fund të vitit 2011 shtetet anëtare të BE-së arritën pajtim në parim për të mbështetur Komisionin Europian për përgatitjen e “Studimit të fizibilitetit për marrëveshjen e stabilizim-asocimit (MSA) me Kosovën”. Pas mbështetjes së studimit nga ana e Këshillit të Europës në shkurt të vitit 2012 dhe përmbushjes së kushteve afatshkurtra nga ana e institucioneve kosovare, në tetor 2013 delegacioni i Kosovës dhe ai i BE-së filluan negociatat për MSA-në. Me përfundimin e negociatave në korrik të vitit 2014 u vunë inicialet në MSA nga ana e kryenegociatores së Kosovës, ministres së Integritetit Europian, Vlora Çitaku dhe kryenegociatorit të BE-së, Zhan-Erik Pakëtan. Përfundimisht, MSA-ja u nënshkrua më 27 tetor 2015 në Strasburg nga kryeministri i Republikës së Kosovës, Isa Mustafa, dhe përfaqësuesja e BE-së, Federika Mogerini. (Ilir Dugolli)

PRODANOVIQ Bozhidar (Božidar Prodanović) (1923-2006). Piktore, grafiste. Lindi në Pranjan të Gornji Milanovcit (Serbi). Kreu shkollimin e mesëm në vendlindje, ndërsa Akademinë e Arteve Figurative në Beograd (1949). Nga vitet 1950-1953 punoi si mësimdhënës në Shkollën e Mesme të Artit në Pejë, ku dha kontribut për zhvillimin e arteve figurative, duke nxjerrë kuadrot e para nga kjo fushë. Më vonë u zgjodh asistent dhe profesor ordinar i teknikave të pikturës murale në Akademinë e Arteve në Beograd. Ekspozoi në manifestimet artistike në Beograd, kryesisht në trienatet e arteve figurative, në Sallonet e Tetorit, në ekspozitat e grafikës etj., si dhe organizoi një numër ekspozitash personale në Beograd, Zagreb, Lubjanë, Rijekë, Novi-Sad, Prishtinë, Pejë etj. Në mesin e veprave të realizuara në teknika të pikturës murale spikat mozaiku “Loja rugovase” në Hotel “Dukagjini” në Pejë. (Hivzi Muharremi)

PRODUKSIONET FILMIKE PRIVATE. Prodhues privatë të filmit në Kosovë, të cilët janë të regjistruar në Qendrën Kinematografike të Kosovës. Në këtë qendër janë të regjistruar gjithsej 129 shtëpi filmike, ndonëse numri i atyre që kanë arritur të prodhojnë një, dy, ose tre filma artistikë apo dokumentarë është relativisht i vogël. Ndër produksionet private të filmit në Kosovë shquhen:

“AS Film Production”, u themelua në vitin 2000 dhe prodhoi një film dokumentar (“Përtej vdekjes”, 2000) dhe tre filma artistikë: “Vjeshta e trëndafilave” (2000), “Anatema” (2006) dhe “Agnus Dei” (2012). Është e vetmja shtëpi filmike në Kosovë që e ka të plotë qarkun teknik për prodhimin e filmit. Me teknologjinë e “AS Film” u xhiruan edhe disa filma artistikë në Kosovë.

“Labis film”, është produksioni privat më i vjetër në Kosovë, i themeluar në vitin 1993. Nisi me prodhimtarinë e filmave artistikë që në vitet ’90. “Viktimat e Tivarit”, “Rruga pa kthim”, “Buka e hidhur”, “Dashuria e Bjeshkëve të Nemuna”, “Kodi i jetës” janë filmat artistikë e televizivë të realizuar nga ky produksion.

“CMB Production”, është produksion që ka kultivuar kryesisht spotin dhe serialet televizive. Në produksion u fut me filmin artistik të metrazhit të gjatë “Tri dritare dhe një varje” të Isa Qosjes. “Gegnia Film”, produksion që ka realizuar filmat e metrazhit të gjatë:

“Krom” (regjia B. Alimani), “Aventurat e babadimrit” (regjia V. Jakupaj) dhe filmat e shkurtër: “Shpresa”, “To be, or not to be” dhe bashkëprodhimet “Çlirimi” dhe “Heshtje”.

“Prishtina film”, është produksion i përqendruar kryesisht në prodhimin e filmit të shkurtër dhe të filmit dokumentar. Është ndër produksionet më të frytshme, që është prezantuar çdo vit në Festivalin “9/11”. Nga produksionet e tjera janë edhe: “Kooperativa”, “IKONE Studio”, “Cine Production”, “Media & Film Production”, “N’Art”, “Circle Production”, “Illyria Film”, “Entermedia”, “Film Mission”, “Aymate”, “Shkupi film” etj. (Gani Mehmetaj)

PRODHIMI BUJQËSOR. Janë prodhimet me orgjinë bimore e shtazore, që shërbejnë për ushqim dhe si lëndë e parë në industri. Duke filluar nga vitet ‘90, trendi i zhvillimit të bujqësisë në Kosovë ndryshoi ndjeshëm: investimet pësuan rënie, bashkë me prodhimtarinë dhe pjesa e popullatës punuese në bujqësi u dyfishua, duke arritur në 50% në fund të asaj dekade. Tregjet tradicionale të eksportit humbën, ndërsa kanalet lokale të marketingut u përçan. Në të njëjtën kohë kishte reduktime drastike të inputeve të subvencionuara, siç ishin plehrat dhe ujitja. Humbja e tregjeve dhe reduktimi i subvencioneve rezultoi me një rënie dramatike në fushën e tregtisë së prodhimeve bujqësore. Në një rrethanë të këtillë, numri i bagëtisë dhe toka bujqësore pësuan rënie të pariparueshme, veçmas në pemëtari, në vreshtari dhe në tokën e pëlleshme. Aktualisht, pjesa më e madhe e fermave në Kosovë janë shumë të vogla (mesatarisht 1,5-2 ha) dhe në masën më të madhe ato janë të orientuara në prodhimin për nevojat e familjes. Vetëm një sasi e vogël e prodhimit në fermë i dedikohet tregut. Sipërfaqet me drithëra përfshijnë sipërfaqet më të mëdha. Bimët industriale (duhani, panxharsheqeri, luledielli), si pasojë e mosfunksionimit të industrisë përpunuese, pothuajse nuk mbillen fare (ose mbillen në sipërfaqe shumë simbolike). Ndërkaq, sipërfaqet me perime kanë tendencë të rritjes, ndërkohë që rritje më e ngadalshme vërehet te sipërfaqet me pemë. Bazuar në kushtet natyrore, në traditën dhe mundësitë për ndërtimin e konkurrencës, është e nevojshme që të zgjidhen sektorët, të cilët do të kenë përparësi, siç janë blegtoria (prodhimi dhe përpunimi i mishit dhe qumështit), bimë për

ushqimin e kafshëve dhe sektori i perimeve dhe i pemëve. Këta sektorë paraqiten mjaft të rëndësishëm, në rend të parë për substitucionin e importit, pasi sasi e madhe e këtyre produkteve importohet nga vende të ndryshme, kryesisht nga vendet fqinje. Në anën tjetër, ekzistojnë resurse mjaft të favorshme natyrore për avancimin e prodhimtarisë në këta sektorë. Zhvillimi i këtyre sektorëve do të ishte shtytës i rëndësishëm edhe për zhvillimin e industrisë përpunuese ushqimore. (Skënder Kaçi)

PRODHIMI I BRENDSHËM BRUTO (PBB).

Vlera monetare e të gjithë produkteve dhe shërbimeve të prodhuara brenda kufijve të një vendi, në një periudhë të caktuar kohore, zakonisht një vit, që në terminologjinë e zakonshme referohet edhe si GDP. Prodhimi i brendshëm bruto përfshin tërë konsumin privat dhe publik, shpenzimet qeveritare, investimet dhe eksportin neto (eksporti minus importi), që zhvillohen brenda një territori të caktuar, në një kohë të caktuar. PBB-ja është treguesi më i gjerë i prodhimit të një vendi dhe përdoret shumë shpesh si tregues i madhësisë së ekonomisë, por gjithashtu edhe si tregues i standardit jetësor në një vend të caktuar. Janë të njohura tri metoda të llogaritjes së PBB-së, si metoda e të ardhurave, metoda e prodhimit (vlerës së shtuar) dhe metoda e shpenzimeve. Metoda e shpenzimeve është metoda më e përdorur në llogaritjen e PBB-së. Sipas saj PBB-ja përbehet nga konsumi i përgjithshëm në vend, nga investimet e përgjithshme private, nga shpenzimet qeveritare dhe nga eksportet neto. Në Kosovë, të dhënat për PBB-në publikohen kryesisht sipas metodës së shpenzimeve. Sipas shënimeve të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, gjatë dhjetë viteve të fundit ka pasur këtë rritje të PBB-së: në vitin 2004 ishte 2,9 miliardë euro, në vitin 2010 ishte 4,4 miliardë euro, kurse më 2014 ishte 5,5 miliardë euro. (Alban Zogaj)

PRODHIMI INDUSTRIAL. Është tregues i prodhimit të përgjithshëm të sektorit të industrisë së një ekonomie. Sektori i industrisë kryesisht përfshin përpunimin e produkteve, minierat, prodhimin e energjisë elektrike dhe të gazit. Prodhimi industrial është mjet i rëndësishëm për parashikim të rritjes ekonomike në vend. Përderisa në të kaluarën prodhimi industrial në Kosovë përbënte rreth

45% të prodhimit të brendshëm bruto, sot ai përbën vetëm rreth 20%. Ekonomia e Kosovës në dekadat e fundit ka kaluar nëpër një proces të deindustrializimit. Aktualisht, publikimet e Agjencisë Statistike nuk japin ende një pasqyrë të qartë mbi vëllimin dhe strukturën e prodhimit industrial në Kosovë. (Alban Zogaj)

PROFILAKSIA (MJEKËSIA PARANDALU-ESE). Është tërësia e masave paraprake, që merren për ruajtjen e shëndetit dhe parandalimin e sëmundjeve të njerëzimit si individ dhe të komunitetit. Profilaksia ndahet në dy grupe: profilaksia e përgjithshme, ku hyn: higjiena e mjedisit dhe e objekteve publike, sigurimi i ujit higjienik për pije, mënjanimi dhe deponimi higjienik i hedhurinave, edukimi shëndetësor i popullatës, dezinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi dhe profilaksia specifike, ku përfshihet: vaksinoprofilaksa, seroprofilaksa, kimioprofilaksa dhe profilaksa me antibiotikë. Kosova ka një traditë të gjatë dhe të mirë me vaksinoprofilaksën. Profilaksia e parë me vakcina është aplikuar në vitin 1948 kundër tuberkulozit, më 1950 pjesërisht kundër difterisë, më 1955 kundër tetanosit dhe më 1959 kundër kollës së bardhë. Ndërsa, si vaksinë e kombinuar difteri, tetanos, kolla e bardhë u aplikua nga viti 1960/61. Në të njëjtin vit filloi edhe aplikimi i vaksinës kundër paralizës së fëmijëve. Nga viti 1993 në Kosovë u aplikua vakcina e kombinuar kundër fruthit, rubellës dhe parotitit, ndërsa kundër hepatitit B nga viti 2001. Institucioni kryesor që merret me parandalim është Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës, me gjashtë institucione rajonale. Falë masave profilaktike specifike sot në Kosovë është eradikuar variola vera, janë eliminuar difteria, tetanosi neonatal, paraliza e fëmijëve, fruthi autokton, rubeola kongjenitale, janë reduktuar në maksimum kolla e bardhë, hepatiti B dhe tuberkulozi. Gjithashtu është eliminuar malaria, kala-azari, tifoja e morrit etj. Sot në Kosovë aplikohen masa bashkëkohore profilaktike dhe kundërepidemike për parandalimin dhe eliminimin e sëmundjeve masive ngjitëse. (Ariana Kalaveshi)

PROGONI Gjon (Novobërdasi) (Magister Johannes Progonouich). Pjesëtarët e familjes arbërore Progoni të Novobërdës i ndeshim që nga vitet 30 të shek. XV. Gjon Progoni, së bashku me dom Nikollë Progonin u vendosën

në Raguzë pas rënies së Novobërdës. Mbante titullin magjistër dhe lidhte kontrata të shumta afariste, në mbështetje të të cilave krijoi vepra të mëdha nga artet e aplikuar. Pas vendosjes në Raguzë, që në vitin 1462 ishte angazhuar nga florentini Martinus Chiarini për t'i punuar një shpatë argjendi, enë për larje etj. Është e njohur një kontratë e tij (1470) me argjipeshkvin e Raguzës (Timoti Maffei), sipas së cilës Gjoni ishte angazhuar t'i punonte një kënatë, një potier, dhe enë për larje, të cilat do t'ia dërgohen për dhuratë mbretit hungarez Mathias Korvini. Vepra më monumentale e Progonit, që zë vend në historinë e arteve aplikative jo vetëm të Raguzës, është "Jezu Krishti i mbërthyer në kryq" (1471). Vepra ruhet edhe sot në Kishën e Gjithë Shenjtërve në Korçullë. Në pjesën e përparme të kryqit shihet Jezu Krishti i mbërthyer. Po në këtë anë në cepa paraqiten figurat relievo të Shën Mërisë, të Shën Gjonit dhe të një apostulli tjetër. Në pjesën e poshtme të kryqit janë paraqitur nëntë vëllezër të gjuhëzuar, ndërsa në pjesën e prapme paraqitet Shën Mëria me të birin. Kryqi është i rëndë 2.80 kg. Vepra është restauruar pjesërisht. Elementet karakteristike të kësaj veprë kanë bërë që studiuesit ta konsiderojnë Progonin si përfaqësues të rëndësishëm të Renesansës në arte aplikative. (Jahja Drançolli)

PROGJIMNAZET. Shkolla shtatëvjeçare (4+3) të hapura në Kosovë nga viti 1946. Pas shkollës fillore katërvjeçare nxënësit regjistroheshin në progjimize trivjeçare. Në fund të klasës së tretë nxënësit kishin provimet e semimaturës. Fillimisht në Kosovë u themeluan 16 shkolla të tilla, kryesisht në qendra të mëdha, por numri i tyre u rrit, varësisht nga numri i nxënësve që kryenin shkollën fillore. Veprimtaria e progjimizeve në Kosovë vazhdoi deri në vitin 1952, kur këto shkolla u shndërruan në gjimnaze të ulëta. Në vitin 1955 gjimnazet e ulëta suprimohen dhe kalohet në arsimin e plotë tetëvjeçar. (Selim Mehmeti)

PROHASKA (Prochaska) Oskar (1876-?). Diplomati austro-hungarez. Lindi në Adamsthal të Brynit (Çekia e sotme). U shkollua në Akademinë Diplomatike të Vjenës. Nga vitet 1901 ishte në shërbimin konsullor, fillimisht në Shkup, më pas në Prizren (1902), pastaj në Manastir (1904) dhe sërish në Prizren (1906-1913). Kur hyri ushtria serbe në Prizren,

gjatë Luftës së Parë Ballkanike dhe ushtri masakra mbi shqiptarët, O. Prohaska doli në mbrojtje të popullsisë civile. Konsulli Prohaska dokumentoi përndjekjen dhe krimet e ushtrisë serbe mbi shqiptarët dhe alarmoi Ministrinë e Jashtme të Perandorisë Austro-Hungareze për përmasat e krimeve serbe. Në këto rrethana ndodhi incidenti diplomatik dhe keqtrajtimi i konsullit Prohaska nga ushtria serbe. Ky incident u raportua në media dhe u kthye në incident diplomatik. Përfaqësuesit e ushtrisë serbe e akuzuan konsullin Prohaska dhe bashkëpunëtorët e tij se po nxisnin shqiptarët për rezistencë ndaj trupave të ushtrisë okupatore. Për një kohë konsullit i humbën gjurmët dhe ky fakt shqetësoi opinionin dhe qeverinë austro-hungareze. Pas një sërë protestash, në janar të vitit 1913 qeveria serbe u detyrua të lejojë rikthimin e konsujve austro-hungarezë në Prizren dhe Mitrovicë. Por konsulli Prohaska nuk qëndroi më në Prizren, pas presionit dhe abuzimeve që kishte përjetuar nga pjesëtarët e ushtrisë serbe. Në shkurt të vitit 1913 u emërua konsull në Rio de Janeiro, Brazil. Afera Prohaska ishte konflikti i parë në një seri konfliktesh të Austro-Hungarisë me Serbinë gjatë luftërave ballkanike. Afera rriti fërkimet midis Austro-Hungarisë dhe Serbisë në Ballkan dhe përshkallëzoi edhe tensionet mes Austro-Hungarisë dhe Rusisë. (Sylë Ukshini)

PROKOPI I CEZARESË (Procopius Caesariensis) (rreth viteve 500-565). Historian i njohur i oborrit të perandorit me origjinë dardane, Justiniani I. Lindi në qytetin Cezarea të Palestinës dhe sipas emrit të këtij qyteti e ndeshim në historiografi. Pasi kishte kryer studimet në shkollën e sofistëve në Gaza, u vendos në Konstantinopojë. Në vitin 527 u emërua këshilltar për çështje juridike dhe sekretar personal i gjeneralit me origjinë ilire, Flavius Belisarius (rreth 505-565). Një pjesë të jetës e kishte kaluar duke e shoqëruar gjeneralin në luftërat perandorake. Pjesën tjetër të jetës deri në vdekje (565) e kaloi duke shkruar për ngjarjet në kohën e perandorit Justiniani I. Prokopi shkroi tri vepra: “De bellis” (Mbi luftërat), “De aedificiis” (Mbi ndërtimet) dhe “Historia Arcana” (Historia e fshehtë). Në këto vepra ndeshim të dhëna të rëndësishme edhe për trevat e Ilirisë. Njoftime interesante për provincën e Dardanisë në kohën e dyndjeve të mëdha të popujve jep sidomos vepra “Mbi

ndërtimet”. Aty, përveç nomenklaturës së gjerë të fortifikatave të ndërtuara dhe të rindërtuara gjatë shekujve IV-VI, do të ndeshim edhe të dhëna shumë të vlefshme mbi gjeografinë dhe toponomastikën e trevave të sotme të Kosovës. Në listën e gjatë të fortifikatave të rindërtuara dhe të ndërtuara nga Justiniani I, që jep Prokopi, spikasin edhe shumë emra qytetesh e lokalitetesh të Ilirisë. (Faik Sahiti)

PROKSHI Ilaz (1949-2007). Shkrimtar. Lindi në fshatin Verboc të Drenasit. Kreu shkollën fillore në vendlindje, të mesmen për kimi në Mitrovicë, ndërsa studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe i mbaroi në Universitetin e Prishtinës. Punoi në Elektroekonominë e Kosovës, në fillim në Elektrolizë e më vonë gazetar dhe redaktor në gazetën “Kosova” të Obiliqit. Me krijimtari letrare u mor që nga fillimi i viteve ‘70. Shkroi vjersha, tregime, novela dhe romane. Bashkëpunoi me gazetat e revistat në Prishtinë dhe në Shkup. Botoi një sërë librash me poezi dhe prozë: “Pikë e bardhë ëndrrë” (1983), “Fytyrë në përgamenë” (1995), tregimet “Daullet e natës” (1990), “Magjia e mjegullës” (1997) si dhe romanet “Fundi i zemërimit” (1997) dhe “Dashuri në labyrinthe” (2001). Për romanin “Fundi i zemërimit” mori çmimin e Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës për vitin 1997 për veprën më të mirë në prozë. (Hasan Hasani)

PROKURIMI. Aktivitet për blerjen e të mirave për nevojat e një organizate, qofshin mallra apo shërbime. Prokurimi publik qeveriset me ligj të veçantë, me të cilin rregullohet procedura e prokurimit, llojet e kontratave, procedura ankimore për palët e pakënaqura dhe organizimi i institucionit të pavarur që shqyrton ankesat e palëve të pakënaqura. Komisioni Rregullues i Prokurimit të Kosovës (KRPK) angazhohet kryesisht në zhvillimin dhe avancimin e prokurimit publik në aspektin e kornizës ligjore, të asistencës teknike dhe trajnimit, kurse Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik (OSHP) trajton ankesat e operatorëve në rolin e një gjykate të shkallës së parë. (Dastid Pallaska)

PROKURORËT E EULEX-IT. Kanë kompetenca dhe përgjegjësi për kryerjen e hetimeve penale dhe për procedurat e lëndëve të reja dhe atyre të pazgjidhura në kuadër të Prokurorisë



SELIA E EULEX-IT NË PRISHTINË

Speciale apo në kuadër të zyrave prokuroriale të caktuar nga kryeprokurori i EULEX-it. Prokurorët e EULEX-it bashkëpunojnë me prokurorët publikë të Kosovës dhe monitorojnë, udhëzojnë dhe i këshillojnë ata. Prokurorët e EULEX-it janë nën autoritetin e veçantë të kryeprokurorit të EULEX-it dhe nuk i nënshtrohen autoritetit të asnjë institucioni të Kosovës. Ata janë kompetentë për hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve që janë në kompetencë të veçantë të Prokurorisë Speciale të Kosovës, por edhe për krimet e tjera që ndiqen nga ligjet në fuqi. Ata janë të integruar në sistemin prokurorial të Kosovës dhe ushtrojnë funksionet e tyre në pajtim me legjislacionin në fuqi të Kosovës. Gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, prokurorët e EULEX-it konsultohen dhe koordinojnë aktivitetet e tyre me kryeprokurorin përgjegjës, në kuadër të zyrës ku janë të vendosur. Siç parashihet në Ligjin për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare mes Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Europian mbi misionin e Bashkimit Europian për sundim të ligjit në Kosovë (prill 2014), prokurorët e EULEX-it që punojnë në kuadër të Task- Forcës Speciale Hetuese (SITF), gëzojnë të gjitha kompetencat dhe autonominë e nevojshme për të vazhduar hetimet, si dhe të kryejnë funksionet prokuroriale në mënyrë të pavarur, pa ndërhyrje apo ndërprerje. (Fejzullah Hasani)

PROKURORIA E APELIT. Institucion prokurorial apelues. Prokuroria e Apelit themelohet për të vepruar para Gjykatës së Apelit në paraqitjen e ankesës apo mbrojtjen kundër ankesës. Prokuroria e Apelit udhëhiqet nga kryeprokurori i prokurorisë, i emëruar sipas Ligjit mbi Këshillin Prokurorial të Kosovës. Prokuroria e Apelit ka juridiksion në tërë te-

rritorin e Republikës së Kosovës. Selia e Prokurorisë së Apelit është në Prishtinë. (Fejzullah Hasani)

PROKURORIA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS. Institucion shtetëror i hetimit dhe i ndjekjes së krimit. Në Kosovë funksionojnë: Prokuroria Themelore, Prokuroria e Apelit, Prokuroria Speciale dhe Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit. Kryeprokurori i Shtetit ka juridiksion në tërë territorin e Republikës së Kosovës dhe juridiksion ekskluziv mbi lëndët në shkallë të tretë, në kuadër të Gjykatës Supreme, si dhe mbi të gjitha lëndët që përfshijnë mjete të jashtëzakonshme juridike. Kryeprokurori i Shtetit mund të marrë në kompetencë secilën lëndë me kërkesë apo pajtim të Kryeprokurorit të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, në secilën prokurori të Republikës së Kosovës. Kryeprokurori i Shtetit është kreu i Prokurorisë së Shtetit. Ai nxjerr rregulla, instruksione, udhëzime dhe vendime për rregullimin e brendshëm të Prokurorit të Shtetit. Selia e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit është në Prishtinë. Ekziston edhe Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK), e themeluar më 2008. Kjo prokurori speciale ka kompetencë ekskluzive në tërë territorin e Republikës së Kosovës për hetimin dhe ndjekjen penale të veprave siç janë aktet e terrorizmit, gjenocidit dhe krimet kundër njerëzimit, krimeve të luftës, rekrutimit të personave në konfliktet e armatosura, organizimit të grupeve për kryerjen e gjenocidit, rrezikimit të personave në mbrojtje ndërkombëtare, përvetësimit të paligjshëm dhe shfrytëzimit të materialeve nukleare, krimit të organizuar, kërcënimit gjatë procedurave penale për krim të organizuar, pastrimit të parave dhe të veprave të ngjashme penale. (Fejzullah Hasani)

PROKURORIA THEMELORE. Institucion prokurorial i instancës së parë që zëvendësoi prokuroritë komunale. Pas aprovimit të ligjit për Prokurorinë e Shtetit (2010) pushuan së funksionuari prokuroritë komunale, të cilat ishin identike me ato të periudhës së KSA të Kosovës. Prokuroria Themelore në Republikën e Kosovës ka juridiksion mbi të gjitha lëndët e shkallës së parë, përveç nëse është paraparë ndryshe më ligj. Prokuroria Themelore formohet me anë të këtij ligji me juridiksion territorial si në vijim: Prokuroria Themelore

në Prishtinë, Prokuroria Themelore në Ferizaj, Prokuroria Themelore në Gjakovë, Prokuroria Themelore në Gjilan, Prokuroria Themelore në Mitrovicë, Prokuroria Themelore në Pejë dhe Prokuroria Themelore në Prizren. (Fejzullah Hasani)

PROKURORITË E QARKUT. Institucion prokurorial i Kosovës që funksionoi deri në vitin 2010. Pas nxjerrjes së ligjit për Prokurorinë e Shtetit (30 shtator 2010), me përcaktimin e strukturës së re prokuroriale, në Republikën e Kosovës pushuan së funksionuari edhe prokuroritë e qarkut, që kishin mbetur nga struktura e prokurorisë së Kosovës që nga periudha e autonomisë. Prej atëherë e deri me hyrjen në fuqi të ligjit të ri të vitit 2010, prokuroria ishte e organizuar në tri nivele: Prokuroria e Kosovës (që kishte juridiksion mbi lëndët në shkallë të tretë dhe me mjete të jashtëzakonshme, në Gjykatën Supreme), Prokuroria e Qarkut (që kishte kompetencë mbi lëndët në shkallë të parë dhe të dytë, në Gjykatën e Qarkut) dhe Prokuroria Komunale (që kishte juridiksion për të gjitha lëndët në Gjykatën Komunale). (Fejzullah Hasani)

PRONA PRIVATE. Është karakteristikë themelore e mënyrës kapitaliste të prodhimit. Në kuptimin ekonomik prona private nënkupton të drejtën e përdorimit të resurseve, me ç'rast të gjitha kushtet e kontraktuara janë të mundshme. Titullari i pronës ka të drejtën e përdorimit të të gjitha të mirave materiale, të cilat trajtohen si objekt i pronës, sikundër që ka të drejtën të largojë të tjerët nga dobishmëria dhe shfrytëzimi i këtyre të mirave materiale, të drejtën e ndryshimit të formës dhe përmbajtjes së të mirave materiale, të drejtën e tjetërsimit, përkatësisht të bartjes së pronës në ndonjë subjekt tjetër. Nga përkufizimi i të drejtave të pronës private rrjedh liria e ndërmarrësisë së personave privatë dhe e asociacioneve të tjera, që në mënyrë të lirë të lidhin kontrata midis tyre. Bartjen dhe realizimin e kontratave e bën shteti nëpërmjet aparatit të tij. Pra, shteti është i obliguar që t'i mbrojë rregullat e punës midis partinëreve të interesuar dhe jo të vendosë për mirëvajtjen e tyre. Prandaj individët hyjnë në këto lidhje në bazë të vullnetit të lirë, me qëllim të realizimit të interesit të tyre personal. Duke marrë parasysh karakteristikat pozitive dhe negative që ka prona private, del se ajo është

karakteristikë e qytetërimit industrial, i cili ndodhet në fund të ekzistencës së tij edhe për këtë arsye kjo formë e pronës konsiderohet si formë e kufizuar e pronës. Prona private në Kosovë ka ekzistuar edhe gjatë periudhës së socializmit, veçanërisht në sektorin e bujqësisë dhe të artizanateve. Tani kjo formë e pronës u shndërrua në formë dominuese në ekonominë e Kosovës. Gjatë procesit të privatizimit të pronës në ish-vendet socialiste vërehet se as prona shtetërore dhe as prona shoqërore nuk janë shndërruar në pronë të mirëfilltë private, por në pronë në formë të rrjeteve (ricombinet) në shumicën e vendeve të Europës Qendrore dhe në pronë të tipit feudal (feit) në ish-Bashkimin Sovjetik dhe në disa vende të Europës Juglindore. (Selman Selmanaj)

PRONA SHOQËRORE. Pronë e bashkësisë së gjerë shoqërore, jo e shtetit, si bashkëpronësi e të gjithë qytetarëve të të njëjtave pjesë të të gjitha mjeteve të prodhimit të shoqërisë. Ky përkufizim i pronës shoqërore nënkupton që rritja e saj fizike dhe vlerore realizohet përmes përcaktimit të amortizimit real dhe përcaktimit të akumulimit real minimal në lartësi të kamatës reale, të akumulimit plotësues dhe të bartjes së rrezikut. Me Kushtetutën e vitit 1974 dhe me Ligjin mbi punën e bashkuar (1976) në ndërmarrjet shoqërore në Kosovë dhe në ish-Jugosllavi janë ndërtuar dy të drejta të veçanta: e drejta në punë me mjete shoqërore dhe e drejta e posedimit të mjeteve shoqërore dhe dy marrëdhënie shoqërore (objekt i pronësisë ishte vet ndërmarrja dhe themeluesit e ndërmarrjes ishin kreditorët rezidual të saj). Si kreditor rezidual paraqitet shteti, i cili përvetëson pasurinë neto të ndërmarrjes, mbulon humbjet e saj përmes fondit rezervë, bashkimit të obligueshëm të akumulimit dhe amortizimit moral dhe real. Të drejtat dhe marrëdhëniet e kësaj formë të pronës janë shpërndarë në shumë titullarë me autorizime të ndryshme, ku pronari nuk dallohet shumë nga poseduesi dhe për këtë arsye vjen deri të tjetërsimi i saj grupor. Mbi bazat e kësaj prone në Kosovë është ndërtuar një lloj industrializimi, veçanërisht gjatë viteve '70 të shekullit të kaluar, në kushtet e të ashtuquajturit socializëm i tregut, përkatësisht socializmi vetëqeverisës, që ishte një specifikë e sistemit ekonomik të ish-Jugosllavisë. (Selman Selmanaj)

PRONA SHTETËRORE. Formë dominuese e pronës në socializmin shtetëror (etatizëm), si pronë e përgjithshme popullore, me të cilën qeveris shteti përmes organeve të veta. Në sistemin e marrëdhënieve të pronës shtetërore, shteti me forcën e vet të detyrimit vendos lidhjet midis shtresave të ndryshme sociale, veçanërisht të klasës punëtore dhe mjeteve shoqërore të prodhimit, posaçërisht të akumulimit shoqëror të kapitalit, në të cilën qëndron forca e tij, por njëkohësisht edhe paaftësia e tij. Përmes kësaj forme të pronës në mënyrë të vazhdueshme shteti riprodhon pozitën e tij monopoliste për sa i përket qeverisjes me mjete të prodhimit, por në të njëjtën kohë riprodhon kundërtënie të kësaj forme të pronës. Si ngjashmëri formale midis pronës shtetërore në etatizëm dhe në kapitalizmin modern është vendosja e drejtorëve që kanë status të punëtorëve publikë, domethënë emërohen dhe shkarkohen nga organet shtetërore, ndërsa diferenca konsiston në sistemin e decentralizuar të tregut të integruar të mallit, të kapitalit dhe të fuqisë punëtore. Pra, të gjitha ndërmarrjet shtetërore në kapitalizmin modern i nënshtrohen formave të ndryshme të konkurrencës së tregut.

Prona shtetërore në Kosovë ka qenë dominuar në periudhën e parë të socializmit (1945-1955), veçanërisht në industri, tregti, infrastrukturë, ndërtimtari etj. Për sa i përket bujqësisë dhe artizanateve, kjo formë e pronës ka dominuar në kombinatet industriale bujqësore (KIB), në ndërmarrjet bujqësore shtetërore dhe në pylltari. Përveç pronës shtetërore në bujqësi, blegtori dhe artizanate, është reflektuar prona kooperativiste, përkatësisht prona e grupit. Thellimi i kësaj forme të pronës është realizuar përmes kolektivizimit, formimit të kooperativave bujqësore fshatare dhe të kooperativave në fushën e artizanateve. Pas suprimimit të autonomisë së Kosovës nëpërmjet një ligji të miratuar nga Kuvendi i Serbisë në vitin 1997 për transformimin dhe privatizimin e pronës, disa ndërmarrje me interes të veçantë janë transformuar nga prona shoqërore në ndërmarrje shtetërore dhe publike. Në këtë ligj janë theksuar 12 ndërmarrje më të rëndësishme të Kosovës, të cilat është synuar që në këtë mënyrë të përvetësohen nëpërmjet shtetëzimit. Mirëpo, të gjitha këto ligje janë shpallë diskriminuese

dhe janë anuluar nga UNMIK-u pas çlirimit të vendit më 1999. (Selman Selmanaj)

PRONËSIA INDUSTRIALE. Është kategori e pronësisë intelektuale. Janë të drejta të paprekshme mbi krijimtarinë intelektuale, e cila përdoret gjatë ushtrimit të aktivitetit industrial dhe që janë në pronësi të një kompanie. Sipas ligjit në fuqi në Kosovë, pronësia industriale përfshin, ndër të tjera, patentat, markat tregtare dhe dizajnet industriale. Ligji përshkruan patentën si një përmbledhje të të drejtave ekskluzive, të cilat i gëzon titullari rreth një shpikjeje në fushën e teknologjisë dhe që përbën risi apo gjen zbatim në industri. Me legjislacionin e Kosovës marka tregtare përkufizohet si shenja apo grupi i shenjave të paraqitura në mënyrë verbale, figurative apo të përzier, të cilat dallojnë produktet dhe shërbimet nga njëra-tjetra. Ligji në Kosovë përcakton se dizajni industrial nënkupton paraqitjen estetike apo ornamentale të një artikulli në përdorim të gjerë, i cili mund të riprodhohet në shkallë industriale. (Dastid Pallaska)

PRONËSIA INTELEKTUALE. Sipas ligjit në fuqi në Kosovë pronësia intelektuale përkufizohet si kategori e të drejtave të paprekshme, që mbrohen krijimtarinë njerëzore intelektuale me vlerë ekonomike. Pronësia intelektuale ndahet në dy kategori kryesore: në pronësinë industriale dhe në të drejtat e autorit. Për dallim nga pronësia industriale, sipas legjislacionit të Kosovës, të drejtat e autorit kanë të bëjnë me krijimet artistike, përfshirë krijimet artistike letrare, muzikore dhe kinematografike, por duke mos u kufizuar vetëm tek ato. (Dastid Pallaska)

PRONËSIA. Fenomen që shoqëron bashkësitë njerëzore, e cila e mbështet ekzistencën e saj mbi pronësinë ndaj natyrës, ndaj mjeteve të prodhimit dhe ndaj produkteve të punës. Pra, prona njëkohësisht është edhe gjendje edhe proces. Në bazë të këtyre fenomeneve rrjedh karakteri i dyfishtë i pronës, i cili shprehet përmes përkatësisë dhe përvetësimit të përhershëm dhe të njëkohshëm të rezultateve që rrjedhin nga prona. Duke u nisur nga përkufizimi i pronës, dallohen tri forma të së drejtës së pronës: e drejta e kontrollit, e drejta e përvetësimit të rezultateve të pronës dhe e

drejta e tjetërsimit, respektivisht e bartjes së pronës në ndonjë subjekt tjetër. Në Kosovë ka pasur prona private, prona shtetërore dhe prona shoqërore, në disa raste edhe prona të grupit. Pas shthurjes së mënyrës socialiste të prodhimit dhe pas luftës së fundit në Kosovë, me qëllim të transformimit të pronës shoqërore në pronë private, në vitin 2002 u themelua Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM), ndërsa në vitin 2008 u themelua Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP). Deri më tani përmes AKM-së dhe AKP-së janë privatizuar 70% e ndërmarrjeve me kapital shoqëror. AKP-ja ka shtrirë aktivitetin e saj vetëm në ndërmarrjet shoqërore dhe në shitjen e aseteve të mbetura pas privatizimit, në disa ndërmarrje përmes likuidimit, por nuk e ka shtrirë aktivitetin e saj në ndërmarrjet publike. Me qëllim të rritjes së efikasitetit të ndërmarrjeve publike, në vitin 2008 Kuvendi i Kosovës e ka nxjerrë ligjin për ndërmarrje publike. Ky ligj ka pësuar ndryshime dhe plotësime në vitet 2012 dhe 2015. Në bazë të këtij ligji, duke përfshirë ndryshimet dhe plotësimet e tij, janë formuar 10 ndërmarrje publike me interes të veçantë dhe 100% janë pronë e shtetit të Kosovës. Njëkohësisht në bazë të këtij ligji janë formuar 8 ndërmarrje publike rajonale me pronësi të përzier dhe 44 ndërmarrje publike lokale, ku shumica e këtyre janë tërësisht pronë e komunave. Me rrumbullakimin e procesit të privatizimit dhe të transformimit të pronës në Kosovë, të gjitha pronat në Kosovë do të jenë prona private dhe prona publike. (Selman Selmanaj)

PRONIA. Pronë tokësore që shteti bizantin ia jepte në shfrytëzim feudalit, kundrejt kryerjes së shërbimit ushtarak. U paraqit në Bizant në gjysmën e dytë të shek. XI. Përfshinte një pjesë fshati, një fshat të tërë ose më shumë fshatra. Të drejtën e pronësisë e kishte shteti, i cili, bashkë me pronien i dhuronte proniarit edhe fshatarët e varur, parikët, të cilët ndodheshin aty. Këta të fundit punonin tokën dhe i paguanin një sërë taksash proniarit, i cili një pjesë ia jepte shtetit, kurse pjesën tjetër e mbante për vete. Proniari, bashkë me një numër ushtarësh, në përpjesëtim me madhësinë e pronies, që e kishte në shfrytëzim, shkonte në luftë sa herë që e ftonte sundimtari. Pronia nuk shitej, nuk ndahej dhe nuk trashëgohej. Pas vdekjes së proniarit, ajo i kthehej pushtetit qendror, i cili ia

jepte në shfrytëzim një proniari tjetër, kundrejt kryerjes së shërbimit ushtarak. Por me pëlqim të sundimtarit ajo mund të trashëgohej nga i ati tek i biri, me kusht që ky të merrte përsipër kryerjen e detyrimeve sikurse paraardhësi i tij. Me kalimin e kohës, proniarët fituan privilegjin e “imunitetit”, duke u çliruar nga ndërhyrja e pushtetit qendror në tokat e tyre dhe duke ngritur një aparat administrativ-gjyqësor, i cili zëvendësoi atë shtetëror. Kështu, në shek. XIV pronia filloi të shndërrohej në zotërim feudal të pavarur, që mund të shitej, të ndahej dhe të trashëgohej. Duke filluar nga shek. XII, pronia që përhapur edhe në viset arbërore nën sundimin bizantin, madje atë e ruajti dhe e shfrytëzoi për interesat e veta edhe Republika e Venedikut në viset e pushtuara të Arbërisë, nga fundi i shek. XIV. Sipas shembullit të sistemit proniar, osmanët ngritën sistemin e timarit. (Qerim Dalipi)

PROSPERITETI EKONOMIK. Njëra ndër fazat kryesore të ciklit të biznesit, e kundërta e recesionit. Në këtë fazë të ciklit të biznesit, aktiviteti ekonomik rimëkëmbet dhe prodhimi i brendshëm bruto rritet me ritëm më të shpejtë. Konsiderohet se në mesatare prosperiteti ose ekspansioni zgjat tri deri në katër vjet. Kosova kishte një ekspansion në periudhën e pasluftës, në vitet 2000-2002, kur kishte rritje të lartë ekonomike pas luftës dhe krizës së viteve '90. Kjo erdhi si rezultat i investimeve të mëdha nga jashtë në rindërtimin e pasluftës, në formë të donacioneve. Më vonë kishte një rënie të rritjes ekonomike, por jo edhe recesion. Rritja ekonomike ishte rritje pozitive mesatare prej 3.3%, që në këtë rast ishte e pamjaftueshme. Edhe teoria ekonomike shpjegon se për ekonomitë e vogla si ajo e Kosovës, kjo rritje mesatare është situatë normale, e cila nuk karakterizohet me ekspansion të lartë, meqë nuk arrin të luftojë disbalancet e mëdha ekonomike, siç është papunësia e lartë dhe deficit i lartë tregtar. (Alban Zogaj).

PROTEKSIONIZMI. Aplikimi i masave apo instrumenteve të ndryshme me qëllim të mbrojtjes së industrive vendore nga importi. Mekanizmat tipikë përmes të cilëve mbrohet një industri vendore janë instrumentet tarifore dhe ato jotarifore. Në grupin e parë hyjnë tarifatat doganore (apo edhe tatime të tjera, si akciza), instrumente që ia rrisin koston produktit për

një përqindje të caktuar në vlerën e importit. Në grupin e dytë hyjnë instrumentet jotarifore, që përfshijnë një sërë mekanizmesh për mbrojtjen e industrive vendore. Këto masa janë shumë komplekse, sepse shpesh edhe nuk janë të destinuara të mbrojnë industritë vendore, por në raste të caktuara synojnë stimulimin e industrive vendore. Rast i tillë tipik është subvencionimi në eksporte. Format më tipike në grupin e instrumenteve jotarifore janë kufizimet sasiore të importit, masat sanitare dhe fitosanitare, barrierat teknike në tregti, rregullat e origjinës; procedurat doganore, pronësia intelektuale, licencat, certifikimet dhe lejet, rregullat e prokurimit etj. Kosova pas vitit 1999 ka proklamuar një ekonomi të lirë dhe pa barrierë në tregtinë e jashtme. Regjimi tregtar i Kosovës është i thjeshtë dhe jodiskriminues (i trajton njëjtë bizneset e huaja dhe ato të brendshme). Nivelet e tarifave në mesatare janë shumë të ulëta dhe nuk janë vendosur me qëllim të mbrojtjes së industrive vendore, por me qëllim të grumbullimit të të hyrave për buxhetin e vendit. Me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes për Stabilizim-Asocim me BE-në dhe me Turqinë, tregtia e Kosovës me jashtë do të liberalizohet gati në tërësi. Masat jotarifore janë gati joekzistente. Edhe ato që janë (lejet, certifikimet, licencat) janë jodiskriminuese në raport me bizneset vendore dhe të huaja. (Petrit Gashi)

PROTESTANTIZMI NË KOSOVË. Fillet e protestantizmit në Kosovë i gjejmë që në vitin 1892, kur Gjerasim Qiriazhi e vizitoi Prishtinën për herë të parë dhe u bë përgjegjësi shpirtëror i lëvizjes protestante për Kosovë. Po atë vit ai emëroi një predikues në Prishtinë. Por ka dokumente edhe në Arkivin e komunës së Prishtinës, pastaj në Stamboll, Londër dhe Vjenë që dëshmojnë se në Prishtinë kishte komunitet protestant në fund të shek. XIX. Në ato dokumente, përveç tjerash, dëshmohet se varrezat e protestantëve, që i quanin “evangelistë” ishin ngritur pranë varrezës hebreje në Prishtinë. Deri pas Luftës së Dytë Botërore, përballë ndërtesës aktuale të Kuvendit Komunal të Prishtinës ishte një kishë protestante. Ndërkaq, në vitin 1963 u hap në Pejë një tjetër kishë protestante, e njohur si “Shtëpia e lutjes”, e cila është edhe sot. Ndërsa në Prishtinë, më 1985, Lëvizja Ungjillore arriti të ndërtojë kishën me emrin “Bashkësia

e Popullit të Zotit”. Në vitin 1992 u hap kisha tjetër në Prizren, e quajtur “Bashkësia Ungjillore e Prizrenit”, ndërsa më 1993 u hap kisha protestante në Gjakovë, me emrin “Bashkësia e Zotit Jezus-Evangeliste”. Tani në Kosovë ka mbi 30 kisha protestante. (Qemajl Morina)

PROTESTAT MASIVE TË VITIT 1988.

Lëvizje masive e qytetarëve të Kosovës kundër ndryshimeve kushtetuese, të cilat cenonin autonominë e Kosovës. Protestat filluan më



DEMONSTRATË E VITIT 1988

17 nëntor 1988, kur minatorët e Stantërgut, afër Mitrovicës, pas mbarimit të turit të natës, dolën nga galeritë dhe u bashkuan me punëtorë të tjerë të Trepçës dhe nisën marshimin drejt Prishtinës. Protestuesit u mblodhën para ndërtesës së Komitetit Krahinor të Lidhjes së Komunistëve të Kosovës dhe më pas në stadiumin e qytetit. Atyre iu bashkuan punëtorë të tjerë, studentë dhe nxënës të shkollave të mesme, të cilët filluan të vinin nga të gjitha qendrat e Kosovës. Numri i protestuesve arriti rreth 100 mijë veta. Tubimi protestues shprehte kundërshtimin e punëtorëve dhe të qytetarëve të Kosovës për ndryshimet e propozuara në Kushtetutën e Republikës së Serbisë, me të cilat suprimohej autonomia e Kosovës e vitit 1974. Gjithashtu protestuesit mbështetnin udhëheqjen autonomiste të Kosovës, e cila u gjend në shenjestër të sulmeve të Serbisë. Protestuesit mbanin flamuj kombëtar, partiakë dhe shtetërorë të Jugosllavisë. Protestuesve iu drejtuan funksionarë politikë të Kosovës dhe iu premtuan se për kërkesat e tyre do të informoheshin të gjitha instancat përkatëse. Pasi nuk u përmbushën kërkesat e protestuesve dhe meqë dhanë dorëheqje apo u liruan nga

funksionet disa anëtarë të Kryesisë së Komitetit Krahinor, përfshirë edhe kryetaren Kaqusha Jashari, rreth 1,000 minatorë të Trepçës as me 18 nëntor nuk zbriten për të punuar në minierë. Minatorëve të Mitrovicës iu bashkuan edhe punëtorët e fabrikave e të reparteve të tjera të Trepçës dhe të kolektivave të tjera punuese. Në të njëjtën kohë protestat u përhapën edhe në qendrat e tjera të Kosovës, në Ferizaj, Deçan, Gjakovë, Gjilan, Viti, Podujevë, Vushtrri etj. Mijëra punëtorë të kolektivave punuese, qytetarë, studentë dhe nxënës u dyndën në drejtim të Prishtinës. Edhe nga qendrat e tjera, si: Suhareka, Kaçaniku, Skënderaj, Deçani, Rahoveci, Dragashi, Glogoci etj., mijëra punëtorë dhe qytetarë u nisën për në Prishtinë. Një numër syresh e bënëin rrugën këmbë, të tjerët me mjete të ndryshme transporti. Brenda dy ditësh protestat u masivizuan në tërë Kosovën. (Luan Tetaj)

PROVINCA E DARDANISË. Provincë e Perandorisë Romake. Pas përfundimit të pushtimit romak të tokave ilire në veri të lumit Mat, u krijua provinca e Ilirikumit (167 deri rreth vitit 10 p.e.r.), ndërsa ato në jug të Matit u përfshinë në provincën e Maqedonisë (148 p.e.r.). Dardania u vendos nën vëzhgimin e prokonsullit të provincës së Maqedonisë dhe në vitet 84-83 p.e.r. u kryen fushatat e para ushtarake kundër dardanëve nga konsujt Sulla dhe Scipioni. Dardania mbeti e pavarur me kushtin e pagimit të një tributi, gjë që shërbeu si pretekst edhe për fushatën e vitit 75 p.e.r. të prokonsullit të Maqedonisë, Kurio, që u nis nga Dyrrahu me 30,000 ushtarë për t'u kërkuar dardanëve "detyrimet e vonuara". Rreth vitit 59, kur me "lex Vatinia" u bë ndarja e provincave midis senatit dhe Cezarit, ky i fundit i organizoi tokat ilire në veri të Matit së bashku me Dardaninë e deri në Istra në veri në një provincë, që u quajt "Illyricum", më shumë si njësi operative ushtarake sesa administrative. Megjithatë, Dardania vazhdoi të administrohej nga provinca e Maqedonisë, sepse prokonsulli i saj, Pisoni, i njohur për korrupsion, u akuzua nga Ciceroni se kishte filluar t'ua shesë shtrenjtë paqen thrakëve e dardanëve dhe si pasojë, me qëllim që ata t'ia paguanin atij këtë shumë, i ka lënë të plaçkitin Maqedoninë. Gjendja e Dardanisë së panënshtuar ruhej ende gjatë luftërave civile, sepse më 49 p.e.r. Pompeu e plotësoi ushtrinë e tij edhe me dardanë dhe besë,

disa prej tyre mercenarë, të tjerët të siguruar përmes pushtetit dhe ndikimit", ndërsa në vitin 38 p.e.r. triumviri Antoni e dërgoi ushtrinë që të luftonte në Dardani. Nënshtrimi i plotë i Dardanisë u realizua nga konsulli Krasid (29-28 p.e.r.), kur sulmoi bastarnët e dyndur në tokën e tribalëve dhe të dardanëve fqinjë dhe i detyroi që të shpërngulen tej Danubit. Legjionet romake nuk ishin vendosur ende në Dardani deri në vitin 16 p.e.r., sepse skordiskët kaluan përmes Dardanisë deri në Maqedoni. Gjatë dhe pas shtypjes së kryengritjes ilire të viteve 6-9, Senati romak krijoi tri provinca të reja në hapësirën e Ilirikut: Panoninë, Dalmatinë dhe Mezinë. Dardania u përfshi brenda provincës së Mezisë gjatë sundimit të perandorit Klaud (41-54). Në vitin 87 perandori Domitian (81-96) e ndau provincën në dy pjesë, ku Mezia e Epërme me qendër Naisin përfshiu pjesën më të madhe të Dardanisë dhe u qeveris nga legati konsullor perandorak dhe një prokurator. Dardania shërbeu për disa dekada si bazë e sulmeve romake kundër dakëve. Dardania mori një rëndësi strategjike veçanërisht për minierat dhe për rrugët.

Ruajtja e identitetit etnik duket ka qenë faktori kryesor për krijimin e provincës së veçantë të Dardanisë nga perandori Dioklecian (284-305). Me vendosjen e tribuve barbarë në Danub dhe humbjen e zotërimeve të tij në kohën e perandorit Aurelian, Dardania mori një rëndësi të veçantë strategjike për bllokimin e dyndjeve barbare drejt Adriatikut apo Egeut. Në vitin 268 gotët u dyndën në provincën e Mezisë dhe perandori Galien (260-268) i theu përfundimisht në betejën pranë Naisit, ku u vranë më se 30,000 gotë. Ndonëse fitorja siguroi për disa kohë qetësinë, në kohën e perandorit Aurelian (270-275) kufijtë u tërhoqën në jug të Danubit, duke shpërngulur legjionet dhe qytetarët romakë në provincën e re, Dacia Aureliana, ndërsa pjesa më perëndimore e Dardanisë u përfshi në Dakinë Mediterane. Dardania ishte një nga nëntëmbëdhjetë provincat e prefekturës së Ilirikut, e cila përveç trevave të mirëfillta ilire përfshinte hapësirat deri te ishulli i Kretës. Dardania bënte pjesë në Dioqezën e Mezisë, pjesë perëndimore e prefekturës së Ilirikut, me provincat Maqedonia e Parë, Maqedonia e Dytë (Salutaris), Thesalia, Epiri i Vjetër, Epiri i Ri, Akeja dhe Kreta. Më pas, dioqeza e Mezisë u nda në atë të Maqedonisë dhe të Dakisë

dhe në këtë të fundit u përfshi dhe provinca e Dardanisë, pa pjesën lindore që mbeti në Mezinë e Epërme.

Gjatë shek. IV u vendos dhe organizimi kishtar në Dardani, me krijimin e peshkopatave të Naisit, Ulpianës, Scupit etj. Peshkopi i Dardanisë, Dacius, mori pjesë në koncilin e Nikesë më 325, ndërsa peshkopi Makedoni i Ulpianës në koncilin e Serdikës më 342. Veçori e kishës së Dardanisë ishte lidhja e ngushtë me papën e Romës edhe pas përkatësisë së Dardanisë Perandorisë Romake të Lindjes në vitin 395. Në konfliktin midis patrikut të Konstantinopolit dhe papës së Romës, që pasoi ndarjen e Perandorisë Romake, peshkopët e Dardanisë morën anën e papës Gezal më 493 në mbështetje “të besimit të mirëfilltë”, ndërsa një letër e papës Simah (514-529) shpreh përkrahjen për peshkopët e Dardanisë në mospajtimin për bashkimin me kishën e Konstantinopolit. Lufta e gjatë duket se ishte bërë çështje e rëndësishme edhe për besimtarët dardanë, përderisa perandori Justinian, me origjinë dardane, krijoi vikariatit e Justinianës së Parë, i cili varej direkt nga papa i Romës dhe kishte në varësi peshkopatat e provincave danubiane, si dhe Dardaninë dhe Prevalitanën. Kur pjesa lindore e Dardanisë me Naisin u pushtua nga sllavët (540), vikariati i Justinianës së Parë u orientua nga Bizanti dhe Pali, peshkop i Ulpianës, i cili mori pjesë në koncilin ekumenik të Konstandinopojës (553). Vikariati qëndroi autonom deri në vitin 733, kur u lidh përsëri me Konstandinopojën. Ndërkohë, ishte krijuar tradita e lidhjeve të forta shpirtërore me Romën dhe kjo traditë e përcaktoi përkatësinë katolike të kishës së trevave antike të Dardanisë, pas ndarjes së dy kishave në shek. XI. Krishterimi masiv i shek. IV-VI ndikoi në ruajtjen e identitetit etnik të trevave të Dardanisë, të cilat u ekspozuan ndaj dyndjeve dhe ngulimeve sllave të shek. VI-VII. Ka pak lajme mbi ngjarjet në Dardani deri në fund të shek. VI. Në vitin 601 një ushtri e dërguar nga perandori bizantin Maurik kaloi në krahinën e Dardanisë, ndërsa qendra peshkopale e Justinianës së Parë përmendet për herë të fundit në vitin 602, para shpërnguljes së klerit në Selanik, nga frika e masakrave. Prania e kishës, e lidhur me popullsinë autoktone krishtere, dëshmon se dardanët nuk u asimiluan dhe se luajtën rol të rëndësishëm në procesin e formimit të popullit shqiptar (Neritan Ceka)

PROZA GOJORE. Lloj i veçantë i krijimtarisë folklorike, i lidhur ngushtë me traditën. Krijimi letrar gojor ruan shumë elemente të modeleve dhe të stilit të traditës, mënyrën e të shprehurit, gjuhën edhe elementet e tjera artistike. Mënyra e krijimit, e transmetimit, e ruajtjes dhe e aritjes së prozës gojore deri në ditët e sotme është e kushtëzuar nga shumë faktorë, siç janë: sistemi i organizimit strukturor kompozicional, sistemi modelativ dhe formulativ, sistemi tematik dhe motivor, gjuha e zgjedhur për secilin zhanër etj. Edhe pse modelet, format dhe llojet e prozës gojore janë të kodifikuara, ato modifikohen me rastin e interpretimeve nga ana e krijuesve-bartësve, të cilët gjatë performimit inkuadrojnë elemente që e cilësojnë të shprehurit individual. Krijimi i prozës gojore nuk cilësohet vetëm me tekstin letrar, por kushtëzohet edhe nga elemente jashtëletrare, si: mimika, gjestikulacioni, interreksioni krijues-marrës etj. Zhanret e prozës gojore kanë përmbajtje që përçojnë mesazhe etike, filozofike dhe edukative, që korrespondojnë me jetën dhe mentalitetin tonë, si dhe me vlerat letrare artistike që janë kultivuar dhe janë përcjellë brez pas brezi, duke iu përshtatur rrethanave dhe mjedisit përkatës. Në odat kosovare proza gojore ka qenë “literaturë” e preferuar, sepse përmes saj është kultivuar shija për të bukurën, ndjenja për mikpritjen, besën, atdhedashurinë, urtinë etj. Në prozën gojore bëjnë pjesë: përralla, kallëzimi, anekdota, fabula, gojëdhëna, legjenda, pleqnitë, tregimet etnografike, përfshirë edhe format e vogla, si fjalët e urta, gjëgjëzat, enigmat, dollitë, urimet, mallkimet, betimet etj. (Myzafere Mustafa)

PROZA MINORE. Pjesë e krijimtarisë folklorike, të cilave u mungojnë etapat e syzheut. Janë formula të shkurtra e koncize për të shprehur një mendim, gjykim, këshillë ose urti, siç janë: fjalët e urta, urtitë popullore, gjëgjëzat, qoftë në prozë apo në vargje, të cilat kanë qëllim zbavitës dhe estetik apo ushtrojnë intuitën, siç janë enigmat popullore, enigmat problemore etj. Pjesë e prozës minore janë “pyetjegjegjet”, që janë ndërtuar në formë dialogu dhe kanë karakter humoristik ose didaktik, pastaj lojërat e fëmijëve, që kanë karakter zbavitës etj. Në këtë lloj të krijimtarisë folklorike hyjnë edhe frazeologjizmat, përsëndetjet, dollitë, urimet, ngushëllimet, betimet, mallkimet etj. Të gjitha këto lloje të prozës minore, ndonëse të shkurtra,

kanë bukurinë e shprehjes artistike. Disa nga llojet e prozës minore, si fjalët e urta, gjëgjëzat etj. në Kosovë janë botuar edhe si vëllime të veçanta. (Leontina Musa)

PROZA TREGIMTARE. Proza tregimtare në Kosovë i prin formës së romanit. Ajo nuk i është shmanjur temës së luftës dhe intencës për ta formuar njeriun e ri. Të kësaj natyre janë tregimet e Sitki Imanit te vepra “Drejt ditëve të reja” (1952) dhe satirat e Ramë Zukës (Zekeria Rexhës) “Talush Efendia” (1973). Mirëpo në vitet ‘60, kjo formë letrare pasurohet me autorët Hivzi Sulejmani, Ramadan Rexhepi, Anton Pashku, Ramiz Kelmendi, Rexhai Surroi, Azem Shkreli, Adem Demaçi, etj, si gërshetim i temave sociale, psikologjike e meditative. Në këtë plejadë me të shquarit janë: Hivzi Sulejmani me veprën “Era dhe kolona” (1960), tregime meditative-sociale, Anton Pashku me veprat “Tregime” (1962) dhe “Nji pjesë e lindjes” (1965), botë letrare e hulumtimeve psikologjike. Ndërsa Ramadan Rexhepi, Rexhai Surroi e Ramiz Kelmendi shkruajnë tregime me tone sociale-ideoogjike për transformimin e njeriut e sidomos të rinisë. Adem Demaçi me tregimet e viteve ‘50 te “Jeta e re”, që mblidhen te vepra “Kur Zoti harron” (1990) kultivon prozën sociale. Azem Shkreli te vepra “Sytë e Evës” (1965) përbashkon rustikalitetin rugovas me meditacionin ekzistencial. Shtysë stilistike kësaj forme i dha Anton Pashku me veprën “Kulla” (1968), tregime që organizohen në rrethin meditativ psikologjik, për t’u shndërruar në model për autorët e mëvonshëm të letërsisë së Kosovës. Në vitet ‘70, autorë të shquar që botojnë vepra tregimesh janë: Eqrem Basha me “Shëtitje nëpër mjegull” (1971) e “Mengjesi i një pasditeje” (1978), si kërkim i paradokseve në psikën e njeriut modern, Teki Dërvishi me “Etja dhe borë” (1972), alegori prozaike për vuajtjen njerëzore, Mehmet Kraja me “Dritat e mesnatës” (1974), rrëfime për preokupimet e brezit të tij, Musa Ramadani me “Fluroma” (1978), rrëfime situatash të preokupimit jetësor, Arif Demolli me “Ballkonet e një qyteze” (1979), rrëfime e skica humoristike-satirike etj. Në vitet ‘80 autorët e sipërpërmendur nuk e latojnë në kontinuitet formën e tregimit, ngase krijojnë edhe në forma të tjera artistike. Mirëpo këtë formë letrare e kultivuan Nexhat Halimi me veprat “Vapë” (1983) dhe “Unë

me unë” (1983) si dhe Ibrahim Berisha te veprat “Fryma e shiut” (1983) e “Të martën mbrëma” (1987). Në vitet ‘90 nga represioni serb u shuan të gjitha institucionet e Kosovës dhe filloi frymë e re e përpjekjes kulturore shqiptare. Por shkrimin e prozës tregimtare e vijuan Musa Ramadani, Eqrem Basha, Mehmet Kraja, Arif Demolli, Ibrahim Berisha etj, të cilët u pasuan nga zërat të rinj si Halil Matoshi, Kim Mehmeti, Abdullah Zeneli etj. Lajtmotiv i tregimit të kësaj periudhe është mbijetesa nacionale. Nga përmbledhjet e kësaj kohe veçojmë: “Marshi i kërmillit” (1994) e Eqrem Bashës si figurë e represionit e çnjerëzimit, “Vdekja pa emër” (1996) e Mehmet Krajës, si figurë e dëshpërimit e mbylljes, “Si mbetën gjallë shqiptarët” (1991) e Arif Demollit si utopi negative ekzistenciale, “Lajmësi memec” (1996) i Halil Matoshit si vizion për kthimin e të humburës, Kim Mehmeti me “Lulehëna” (1997) si risemantizim i miteve, pastaj Beqë Cufaj me veprën “205” (1996) si pikëpyetje e krizave identitare. Në këto vite duhet të përmendim edhe veprën “Mjeshtri i vetmisë” (1995) të Zejnullah Rrahmanit, e cila shquhet për fiksjonalizimin e situatave personale. Mbas luftës së vitit ‘98-‘99, janë pikërisht autorët e formuar në vitet ‘70, të cilët e vijnë shkrimin e prozës tregimtare, krahas formave të tjera të prozës. Ndërsa tregimin si të tillë e sprovajnë disa autorë të rinj, siç janë: Fahredin Shehu, Gëzim Aliu, Adil Olluri, Ballsor Hoxha etj. (Nysret Krasniqi)

PRUTHI Vahdet (1943-). Gjeolog, profesor universiteti. Lindi në Gjakovë, ku kreu shkollën fillore dhe të mesme, studimet në fushën e gjeologjisë i ndoqi në Universitetin e Beogradit, ku u diplomua në



VAHDET PRUTHI

drejtimin e hartografimit gjeologjik (1968). Studimet e magjistraturës në drejtimin për minerale të dobishme i kreu në Universitetin e Zagrebit (1981), ndërsa doktoratën e mbrojti në Universitetin e Prishtinës, në lëmin e aplikimit të metodave të Remote Sensing-ut në studimin e gjeologjisë së Kosovës (1986). Ka punuar inxhinier gjeolog në minierën e kromit Deva në Gjakovë. U emërua pedagog në Fakultetin e

Shkencave Matematike-Natyrore në Universitetin e Prishtinës (1970) dhe për shumë vite ligjëroi disa lëndë, si bazat e gjeologjisë, hartografimi gjeologjik, metodat e hulumtimit të mineraleve të dobishme, gjeologjia e Kosovës, bazat e hidrogeologjisë, Remote Sensing-ut dhe gjeologjia e mjedisit. Ligjëroi edhe në Fakultetin e Xehetarisë dhe të Metalurgjisë. Botoi një varg studimesh e artikujsh për çështjet e ndryshme gjeologjike të Kosovës, në revistat shkencore vendore e ndërkombëtare. Ishte udhëheqës dhe pjesëmarrës i shumë projekteve profesionale dhe shkencore vendore e ndërkombëtare dhe bashkorganizator i konferencave të ndryshme gjeologjike, kryetar dhe anëtar i komisionit shtetëror për rezervat minerale të Kosovës (1984-1988), kryetar dhe anëtar i Komitetit Jugosllav për Minerale të Dobishme (1982-1984), anëtar i Komisionit të IGCP-së të ish-Jugosllavisë për bashkëpunim gjeologjik me UNESCO-n dhe kryetar i Shoqatës së Gjeologëve të Kosovës. Ka qëndruar për studime shkencore në Poloni, Bullgari, Rusi, Francë, Shqipëri, SHBA etj. (Valbon Bytyçi)

PRRUTHI Enver (1931-1999). Agronom. Lindi në Gjakovë, ku kreu shkollën fillore dhe të mesme. Studimet për pemëtari-vreshtari i përfundoi në Fakultetin e Bujqësisë të Universitetit të Beogradit (1962). Si bursist i OECD-së mbaroi një specializim për mbrojtjen e bimëve në Francë dhe kreu një studim profesional në SHBA për metodat më të reja të kultivimit të pemëve (1969). Punën e agronomit e filloi në ndërmarrjen "Ereniku", udhëheqës i njësish së vreshtarisë (1972). Ishte kryetar i Kuvendit Komunal të Gjakovës (1974) dhe më vonë drejtor i grupit investues i Hidrosistemit "Radoniqi" (1978) dhe drejtor i përgjithshëm i kësaj ndërmarrjeje. Mori pjesë në shumë simpoziume dhe konferenca shkencore e profesionale. (Bashkim Kabashi)

PSEUDOSHOQËRUESIT ULPIANAS (PSEUDOCOMITATENS). Garnizone ushtarake të Perandorisë Romake, të formuara në vitin 373 për mbrojtjen e qyteteve dhe kufijve. Nga lista e posteve ushtarake gjatë sundimit romak (Notitia Dignitatum) mësojmë se qyteti i Ulpianës kishte garnizonin e tij ushtarak të pseudoshoqëruesve, të cilët ishin nën komandën e magistrut ushtarak për Ilirikun (magister millitum per Illyricum) i vendosur në

metropolin e Ilirisë antike, Sirmium (Sremska Mitrovica) të Panonisë. Sipas shkrimeve të gjeografit bizantin Hierokles në veprën e tij "Synekdemo", deri në shekullin VI sigurinë në Dardani e mbanin pseudocomitatens Scupiensis (Shkupi), Ulpianenses (Ulpiana) dhe Merenses (Merioni) (Arianit Buçinca)

PUKA Gëzim (1961-). Dizajner, arkitekt. Lindi në Prishtinë. Kreu shkollimin e mesëm në Prishtinë, ndërsa studimet për dizajn në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës (1983). Në vitin 1991 bëri një vizitë studimore në Institutin "Cantu D'arte" në Itali. Në vitin 1983 filloi punë në një kompani inxhinierike që merret me projekte ekzekutimi dhe renovimi të ndërtesave, ndërsa në vitin 1991 hapi studion e tij në Prishtinë "Puka Design". Krijimtaria e tij artistike përfshin dizajnin arkitektonik me një stil të veçantë, që parqet një kombinim midis tradicionales dhe modernes. Nga viti 1984 mori pjesë në disa ekspozita kolektive në Kosovë dhe jashtë. Për krijimtari artistike dhe punë profesionale u shpërblye disa herë dhe realizoi shumë projekte nga fusha e dizajnit. (Zeni Balazhi)

PUKVIL Fransua (François Pouqueville) (1770-1838). Shkrimtar francez, historian, diplomat, mjek, udhëpërshkrues. Studioi në Kaen dhe Sorbonë. Me diplomaci dhe me shkrime i kontribuoi çlirimit dhe rilindjes së popullit grek. Ishte nismëtar dhe ideator i filohelenizmit në Europë. Shërbeu konsull i përgjithshëm i Napoleon Bonapartit në pallatin e Ali pashë Tepelenës në Janinë. Ishte rob dhe mjek i pashait të Peleponesit. Veprat e tij janë: "Udhëtime në More, Konstandinopojë, Shqipëri dhe në pjesët e tjera të Perandorisë Osmane më 1798, 1799, 1800 dhe 1801" (Voyage en Morée, a Constantinople en Albanie et dans plusieurs autres parties de l'Empire otoman pendant les années 1798, 1799, 1800 et 1801, botuar më 1805), "Udhëtime në Epir, Shqipëri, Maqedoni dhe Thesali" (1820), "Historia e rigjenerimit të Greqisë" (1824) e përkthyer në shumë gjuhë etj. Punimet e tij ofrojnë përshkrime të detajuara të zonave jugore të Shqipërisë. (Pranvera Osmani)

PULA Besnik (1975-). Publicist, sociolog. Lindi në Prishtinë. Në vitin 1991 bashkë me familjen emigroi në SHBA. Studimet baçelor i

përfundoi në Hunter College, SHBA. Magjistroi në Georgetown University, në Studimet Euro-Azi dhe ato të Europës Juglindore. Studimet e doktoratës i kreu në Universitetin e Miçigenit. Në vitin 2014 u zgjodh mësimdhënës në departamentin e shkencave politike dhe marrëdhënieve ndërkombëtare në Institutin Politeknik të Virgjinias. Ka hulumtuar dhe ka publikuar studime nga fusha e ekonomisë -politike krahasuese të vendeve në zhvillim. Hulumtimet e tij janë publikuar në revista të ndryshme në Kosovë dhe jashtë. (Nita Luci)

PULA Gazmend (1954-). Inxhinier i elektroteknikës, mësimdhënës universiteti. Lindi në Zveçan, komuna e Mitrovicës. Shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në Prishtinë, studimet për inxhinieri elektrike në Fakultetin Teknik të Universitetit të Prishtinës (UP) (1977). Paralelisht me studimet e elektroteknikës, kreu edhe studimet për gjuhë dhe letërsi angleze në Fakultetin e Filologjisë të UP-së.



GAZMEND PULA

Studimet pasuniversitare i filloi në Universitetin e Zagrebit dhe i përfundoi në Universitetin "Xhorxh Uashington" në SHBA (1981), ndërsa disertacionin e mbrojti në Fakultetin Elektroteknik të UP-së (1995). Më 1979 u zgjodh asistent dhe më pas docent dhe profesor i asociuar për lëndët bartja dhe shpërndarja e energjisë elektrike dhe rregullimi i sistemeve elektroenegjetike (2005). Qëndroi për specializim nga fusha e elektroenegjetikës në disa universitete dhe institute europiane. Si autor dhe bashkautor botoi punime shkencore në revista të vendit dhe ato ndërkombëtare. Është autor i dy teksteve universitare. G. Pula, që nga vitet '90 zhvilloi edhe aktivitet politik. Ishte themelues Komitetit të Helsinkit për Kosovë (1990) dhe mori pjesë në një sërë konferencash ndërkombëtare për çështje të demokracisë dhe të drejtave të njeriut. Ka qenë ambasador i Republikës së Kosovës në Republikën e Shqipërisë (2008-2010). (Isuf Krasniqi).

PULA Xhevdet (1924-2006). Kimist, profesor universiteti. Lindi në Gjakovë. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje dhe në Pejë. Më 1952 kreu studimet për kimi në

Universitetin e Beogradit dhe më pas punoi në laboratorin e kimisë të Kombinatit "Trepça" në Zveçan. Nga viti 1960 ishte udhëheqës i laboratorit të përgatitjes së ujit në Kombinatit "Kosova" dhe më vonë drejtor i industrisë kimike në këtë kombinat. Ka bërë udhëtime studimore në SHBA dhe në Gjermani, për proceset e gazifikimit të qymyrit dhe të plehrave azotike. Studimet pasuniversitare të kimisë inxhinierike i përfundoi në Fakultetin Teknologjik të Universitetit të Zagrebit (1975), ku më pas mbrojti dhe tezën e doktoratës (1979). Në vitin 1976 u zgjodh ligjërues i lartë në Fakultetin Teknik të Universitetit të Prishtinës, ndërsa më 1980 mori titullin e profesorit të rregullt. U mor edhe me punë shkencore, kryesisht nga fusha e përparimit të proceseve kimike dhe të kondicionimit të ujërave për repartet industriale, si dhe ka përkthyer disa tekste të shkollave të mesme. (Minir Dushi)

PULA Ymer (1921-2000). Pjesëmarrës i Luftës Nacionalçlirimtare, funksionar i lartë i Kosovës në periudhën e autonomisë. Lindi në Gjakovë. Shkollën fillore e kreu në vendlindje.



YMER PULA

Më 1932 shkoi në Shqipëri. Në Shkodër regjistroi gjimnazin dhe më pas u bë anëtar i grupit komunist të Shkodrës. Më 1941 u përjash-tua nga gjimnazi dhe u burgos për shkak të pjesëmarrjes në demonstratat antifashiste. Me krijimin e PK të Shqipërisë u zgjodh anëtar i KQ të Rinisë Komuniste të Shqipërisë (1941). Më 1942 u burgos sërish dhe u dënua me një vjet burg. Kërkoi transferim nga burgu i Tiranës në Kosovë dhe në rrugë e sipër arriti të ikte dhe u vendos në Gjakovë. Më 1942 u zgjodh sekretar i Komitetit të Rrethit në Gjakovë. Në vitin 1943 u inkuadrua në aradhen partizane "Bajram Curri". Ishte pjesëmarrës i Konferencës së Bujanit dhe nënshkruer i Rezolutës së saj. Pas luftës kreu Shkollën e Lartë Politike "Gjuro Gjakoviç" dhe Fakultetin Ekonomik në Beograd. Kreu funksione me rëndësi në organet krahinore dhe federative të pushtetit dhe të qeverisjes: komisar i Qarkut të Pejës, sekretar i Këshillit të Rrethit të Gjakovës, sekretar i Rrethit të Kamenicës, kryetar i Komitetit për

Industri dhe Xehetari në Këshillin Ekzekutiv Krahinor të Kosovës, drejtor i “Rilindjes”, anëtar i Komitetit Krahinor dhe deputet i Kuvendit Federativ. Më pas u zgjodh anëtar i Këshillit Ekzekutiv të Serbisë, më 1971 anëtar i Këshillit Ekzekutiv Federativ dhe ministër Federativ për Treg dhe Çmime. Më 1982 u emërua kryetar i Këshillit Ekzekutiv të Kosovës, delegat i Kuvendit Federativ dhe kryetar i Këshillit për Plan i Dhomës së Republikave dhe Krahinave etj. Vdiq në Prishtinë. (Daut Bislimi)

PULA-KASAPOLLI Lirika (1983-). Pianiste. Lindi në Gjakovë, ku mori mësimet e para për muzikë. Vazhdoi shkollimin në Prishtinë te prof. A. Shujaku. Mbaroi studimet themelore për piano në Tiranë, ndërsa ato master në Shkup, në klasën e prof. T. Svetiev (2011). Është pjesëmarrëse aktive në masterkurse pianistësh ndërkombëtare, si në “Academia Musicale Chigiana” në Itali (2013) drejtuar nga pianistja Lilya Zilberstein. Është pianiste aktive në skenën muzikore të Kosovës dhe më gjerë. Në vitin 2016, me sopranon Besa Lluguqi, kurorëzuan bashkëpunimin me performanca brenda e jashtë vendit, si në: “Fem Art Festival” në Prishtinë, “Les Concerts du Foyer Europeen” në Luksemburg etj. Repertori i saj muzikor përfshin vepra periudhash të ndryshme, pa lënë anash interpretimet e muzikës bashkëkohore dhe të autorëve shqiptarë. Nga viti 2006 është pedagoge e pianos në Shkollën e Muzikës në Prishtinë dhe e angazhuar shoqëruese në katedrën e solokëndimit dhe atë të harqeve në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. (Kristina Palokaj-Perkola)

PULA-PETROVCI Valbona (1958). Pianiste. Lindi në Prishtinë, ku kreu Shkollën e Mesme të Muzikës, drejtimi i pianos (1966-72). Studimet për piano i përfundoi në Fakultetin e Arteve në Prishtinë (prof. E. Korolov, I. Dimçevska) (1976-80), duke dalë pianistja e parë në Kosovë. Gjatë viteve 1982-92 ndoqi kurset intensive me prof. J. C. Vanden në Belgjikë dhe J. M. Dare në Francë. Studimet pasuniversitare i përfundoi në Shkup më 2001 (prof. J. Çakar). Nga viti 1981 u angazhua si



VALBONA PULA-PETROVCI

bashkëpunëtoresh profesionale për lëndën piano obligat në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës, ku më 1989 mori titullin ligjëruese për piano, pastaj dhe profesore e rregullt në këtë drejtim. Aktiviteti i saj artistik-interpretues në vend, rajon e më gjerë filloi në vitin 1976, duke performuar edhe në Dubrovnik, Opat, Zagreb, Lubjanë, Novi-Sad, Beograd, Tiranë, ku interpretoi vepra të kompozitorëve botërorë, por edhe të autorëve vendorë. Në një mandat prof. Pula-Petrovci ishte prodekane e Fakultetit të Arteve. Vazhdoi punën e pedagoges së pianos në degët e muzikës së këtij fakulteti. (Rreze Kryeziu-Breznica)

PULAHA Selami (1938–1991). Historian, osmanolog. Lindi në qytetin e Korçës. Kreu studimet në Fakultetin Histori-Filologji (1959) të Universitetit të Tiranës. Punoi disa vjet si mësues i historisë në qytetin e Lezhës. Nga viti 1963 punoi si kërkues shkencor në Institutin e Historisë e të Gjuhësisë (sektori i mesjetës). Nga viti 1972–1989 mbajti detyrën e zëvendës-drejtorit të këtij Instituti, kurse nga viti 1989 dhe derisa vdiq ishte drejtor i Institutit të Historisë. Veprimtarinë e tij shkencore ia kushtoi kryesisht shekujve të parë të sundimit osman (shek. XV–XVI). Është autor i monografisë “Pronësia feudale në tokat shqiptare (shek. XV–XVI)” (1988) dhe i përmbledhjes me studime “Popullsia shqiptare e Kosovës gjatë shek. XV–XVI” (1984). Përgatiti për botim vëllimet me dokumente: “Lufta shqiptaro-turke dhe Gjergj Kastriot-Skënderbeu (Burime osmane)” (1968), “Regjistri i kadastrës së Shkodrës i v. 1485” (1974), “Qëndresa e popullit shqiptar kundër sundimit osman nga shek. XVI deri në fillim të shek. XVII” (1978), “Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare” (1978) dhe “Dokumente të shek. XV–XVI për historinë e Shqipërisë” (1989). Është bashkautor i veprave “Historia e Shqipërisë” (1972). Ka botuar një varg artikujsh në revista shkencore brenda dhe jashtë vendit dhe ka mbajtur leksione në studimet universitare dhe pasuniversitare në Universitetin e Tiranës dhe në Universitetin e Prishtinës. (Dritan Egro)

PULATI Elena (1900-1986). Veterane e arsimimit. Lindi në Shkodër, ku kreu edhe shkollën fillore. Shkollën e mesme fetare e kreu në Romë. Gjithë jetën ia kushtoi veprimtarisë

arsimore. Punën e mësueses e filloi në Shkodër, ndërsa për më shumë se katër dekada e vazhdoi në Maqedoni. Më 1944 emërohet mësuese në Gostivar, pastaj në Tetovë, në shkollën fillore "Liria", ku punoi më shumë se tri dekada. Shquhej për punën mësimore- edukative dhe dashurinë për profesionin e mësuesit. Kontribuoi në emancipimin e femrës shqiptare në Tetovë dhe në Maqedoni. Veprën e mësueses E. Pulati qytetarët e Tetovës e përjetësuan me një përmendore në këtë qytet. (Myqereme Rusi)

PULEVSKI Gjorgji (Đorđe Puljevski) (1817-1895). Leksikograf. Lindi në Galiçnik, katund i Rekës së Vogël në qarkun e Dibrës në Maqedoni. Jetoj në mërgim në Rumani, Serbi (Beograd) dhe Bullgari (Sofje). Mori pjesë në disa luftëra e kryengritje serbe, bullgare dhe maqedonase kundër Perandorisë Osmane. Në vitin 1878 ishte prefekt i Qystendillit, kryetar i shoqërisë letrare sllavo-maqedonase me seli në Sofje në vitin 1888. Autodidakt, murator, ka lënë gjurmë si leksikograf. Është autor i fjalorit katërgjuhësh: maqedonisht-shqip-turqisht-greqisht (Beograd, 1873) dhe i fjalorit bisedimor tregjuhësh: maqedonisht-shqip-turqisht (Beograd, 1875). Fjalori katërgjuhësh ka 2,560 fjalë e shprehje shqipe. Fjalori tregjuhësh është i tipit pyetje-përgjigje. Fjalori katërgjuhësh është shtypur me alfabetin cirilik tradicional, ndërsa në fjalorin tregjuhësh është përdorur alfabeti cirilik i reformuar i V. Karaxhiqit. (Berton Sulejmani)

PULTI (Polatum). Rajon në Shqipërinë e Veriut, që përfshinte pjesën malore verilindore të qarkut të Shkodrës, përkatësisht pjesën jugperëndimore të Alpeve Shqiptare. Hapësirë bazë e shtrirjes së këtij rajoni është lugina e lumit Kir me gjashtë katunde, përfshirë edhe vendbanimin antik Drishtin (Drivastum). Pulti i sotëm (Polatum i mesjetës) ishte i banuar qysh në antikitet dhe në mesjetën e hershme. Në shek. IX në këtë hapësirë ishte ngritur një ipeshkvi me 18 famulli katolike, që përfshinte më shumë territor se ç'përfshin Pulti i sotëm. Ky territor u zgjerua gjatë shek. XII-XV me viset rrafshinore përreth. Pulti si rajon për herë të parë dëshmohej në kartën e Nemanjës dedikuar Hilandarit më 1198. Aty thuhet se Nemanja kishte pushtuar "Pultin nga Arbërit". Përmbajtje pothuajse identike ndeshim edhe

në jetëshkrimin e Shën Savës (1208), ku thuhet se: "Mori nga bregdeti vendin Zeta me qytete, nga Rabani të dy Pultet". Rabani në këtë burim ka kuptimin e Arbërisë, ndërsa rajoni i Pultit atëbotë ishte ndarë në Pultin e Poshtëm dhe Pultin e Sipërm. Në shek. XII anali i abatis i Dioklesë e zë në gojë me emrin Poletum në cilësi të ipeshkvisë brenda juridiksionit të argjipeshkvisë së Tivarit. Pas pushtimit të shkurtër nga dinastia e Balshajve, Pulti u sundua nga familja e Dukagjinëve deri në vdekjen e Lekë Dukagjinit (1481) dhe u quajt, si edhe sot: Dukagjin. (Skënder Gashi)

PUNËSIMI. Paraqet marrëveshje ndërmjet dy palëve, punëmarrësit dhe të punësuarit, ku ky i fundit ofron shërbime kundrejt një page. Në një marrëveshje të tillë përcaktohet puna që do të kryhet, kushtet e punësimit, vendi, kohëzgjatja dhe kushtet e tjera. Norma e punësimit paraqet raportin e të punësuarve ndaj popullsisë në moshë pune dhe jep një indikacion se deri në çfarë mase është duke u përdorur resursi njerëzor në një ekonomi. Kjo normë gjithashtu jep indikacione për gjendjen në të cilën gjendet ekonomia. Struktura e punësimit sipas sektorëve tregon nivelin e zhvillimit të një ekonomie, kur punësimi më i lartë në sektorët e shërbimeve tregon për nivel më të lartë të zhvillimit ekonomik dhe diversifikim ekonomik. Të punësuar janë personat që gjatë javës referuese kanë kryer çfarëdo lloj pune, me pagesë monetare ose me pagesë tjetër, ose për përfitim familjar, përfshirë edhe personat që përkohësisht mungojnë nga puna. Në Kosovë, sipas të dhënave për vitin 2014, ka pasur 323,508 persona të punësuar, prej të cilëve meshkuj 248,224 dhe femra 75,284. Norma e punësimit ka qenë 26.9%, që nënkupton se më pak se 3 në 10 persona të moshës së punës janë të punësuar. Norma e punësimit ka qenë shumë e ulët për femra (vetëm 12.5%) krahasuar me meshkujt (41.3%). Normë më të lartë të punësimit ka grupmosha 45-54 vjeç prej 38.1%, ndërkaq më të ulët ka grupmosha deri në 24 vjeç, prej 9%. Në parim, norma e punësimit rritet me nivelin arsimor, ndërkaq normë më të lartë të punësimit kanë personat me arsim profesional. Sa i përket formës së punësimit, 68.2% e të punësuarve në Kosovë punojnë me pagë, 23.2% janë të vetëpunësuar dhe 8.6% konsiderohen punëtorë familjarë. Krahasuar me meshkujt, femrat tentojnë

të jenë më shumë të punësuar me pagë të rregullt. Shumica e të punësuarve prej 84.5% punojnë me kontratë. Pa kontratë punojnë kryesisht personat e moshës së re. Sa i përket punësimit sipas sektorëve, rreth gjysma e të punësuarve punojnë në prodhim, tregti, arsim dhe ndërtimtari. Femrat tentojnë të punojnë kryesisht në arsim dhe në shëndetësi (ku punojnë rreth 40% e femrave të punësuar), ndërkaq rreth 40% e meshkujve punojnë në prodhim, tregti dhe ndërtimtari. Shumica absolute e të punësuarve, 91.7% punojnë me orar të plotë, ndërkaq pjesa tjetër me orar të pjesshëm. Femrat tentojnë më shumë me orar të pjesshëm se meshkujt. Rreth 60% e të punësuarve punojnë 40-48 orë në javë, 13% më shumë se 48 orë në javë dhe pjesa tjetër më pak se 40 orë në javë. Në përgjithësi, meshkujt punojnë me orar më të gjatë se femrat, 28% e meshkujve të punësuar punojnë më shumë se 48 orë në javë krahasuar me 11.5% të femrave të punësuar. Në sektorin privat, orët mesatare të punës në javë janë 47, ndërkaq në sektorin publik 38 orë në javë. (Avdullah Hoti)

PUNËTORITË ANTIKE GURSKALITËSE. Vendpunime gurskalitëse në Dardani. Punëtoritë më të hershme u formuan në koloninë e Scupit, duke filluar nga fundi i shek. I. Në fillim të shek. II veproi një punëtor i një pjesën jugore dardane, rreth stacionit Llamud, te Llopati. Në nismë e në mesin e shek. II u themeluan punëtoritë edhe në Ulpianë dhe emërohen në mbishkrimet dhe gjentilicet perandorake, Flavi dhe Ulpi. Në territorin e Ulpianës gjendej edhe punëtoritë në luginën e Lepencit, te Kaçaniku. Diçka më vonë u formuan punëtoritë edhe në dy qendrat e tjera municipale, në çerekun e dytë të shek. II në Dërsnik, ku në mbishkrime emërohen pelegrinët dhe Ulpi e Aeli, kurse rreth mesit të shek. II në Municipin DD. Në gjysmën e dytë të shek. II punëtoritë u themeluan në dy qendrat e tjera antike, njëra te Kllokoti dhe dy të tjera në territorin e Suharekës, njëra në arealin e ngushtë dhe tjetra diku në trevën e Rahovecit apo të Prizrenit. Kjo e fundit i takon kohës së hershme të perandorit Sever, meqë në mbishkrime emërohen si Aureli dhe Septimi. Në pjesën veriore dardane punëtoritë u themeluan në dy qendrat e rëndësishme, nga mesi i shek. II në Timak Minus dhe nga gjysma e dytë e shek. II në municipin e Naisit.

Njëra gjendej edhe rreth Aleksincit të sotëm. Veprimtaria e punëtorive u zhvillua deri në fund të shek. III dhe me ekzemplarë të rrallë deri në fillim të shek. IV. Në to kryesisht punuan mjeshtrit vendorë, por ndeshen dhe punime të mjeshtrëve të huaj. (Exhlale Dobruna-Salihi)

PUPOVCI Dukagjin (1964-). Matematikan, aktivist në fushën e arsimit. Lindi në Prizren, shkollën fillore dhe të mesme i mbaroi në Prishtinë, studimet e matematikës i për-



DUKAGJIN
PUPOVCI

fundoi në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore (FSHMN) të Universitetit të Prishtinës (UP) në vitin 1985. Magjistroi në fushën e matematikës aplikative në Universitetin e Zagrebit (1989) dhe tezën e disertacionit të doktoratës e mbrojti në FSHMN të UP-së (1998). U zgjodh asistent në departamentin e matematikës të FSHMN-së në Prishtinë, ku më pas merr edhe titullin profesor. Ligjëroi lëndë të ndryshme nga fusha e matematikës dhe e shkencave kompjuterike, deri sa angazhohet mësimdhënës në programet e Fakultetit të Edukimit (2010). Publikoi disa punime shkencore dhe është autor dhe bashkautor i një numri të studimeve dhe librave nga fusha e arsimit, të publikuara në vend dhe jashtë. Mori pjesë me punime në tubime shkencore vendore dhe ndërkombëtare. Kreu detyra dhe funksione të ndryshme në institucionet e arsimit të lartë. Është drejtor ekzekutiv i Qendrës për Arsim të Kosovës (KEC), organizatë joqeveritare e specializuar në fushën e arsimit. (Qamil Haxhibeqiri)

PUPOVCI Syrja (1937-1998). Jurist, profesor universitar, akademik. Lindi në Pejë, shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në vendlindje, ndërsa Fakultetin Juridik në Beograd, ku në vitin 1965 mbrojti edhe disertacionin me temën: "Marrëdhëniet juridike-civile në Kanunin e Lekë Dukagjinit". Në vitin 1966 u zgjodh docent, më pastaj profesor inordinar dhe më 1974 profesor ordinar i lëndës e drejta familjare me sociologji të familjes në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës. Në procesin mësimor kontribuoi deri në shtator të vitit 1991, ndërsa nga 1 tetori i vitit 1992 u largua



SYRJA PUPOÇVI

nga puna nga organet e dhunshme serbe. Kreu disa funksione dhe detyra me përgjegjësi në institucionet e arsimit të lartë: ishte prodekan i Fakultetit Juridik dhe prorektor i Universitetit të Prishtinës. Në vitin 1975 u zgjodh

anëtar i rregullt i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (ASHAK), ku ushtroi detyrën e sekretarit të seksionit të shkencave shoqërore (1975-1979), të nënkryetarit (1979-1984), si dhe të kryetarit të ASHAK-ut dhe të anëtarit të Këshillit të Akademive të Shkencave dhe të Arteve të Jugosllavisë (1984-1986). Një mandat ishte delegat i Dhomës Federative të Kuvendit të RSFJ-së. Ishte kryetar i Komisionit Legjislativ-Juridik të Dhomës Federative dhe anëtar i Komisionit Kushtetues të Kuvendit të RSFJ-së. Në veprimtarinë e tij kërkimore-shkencore u mor me të drejtën zakonore shqiptare, sidomos të drejtën zakonore familjare dhe civile. Në shumë studime trajtoi aspekte të ndryshme zakonore-juridike të Kanunit të Lekë Dukagjinit, duke e bërë të njohur në opinionin shkencor njërin nga monumentet më të veçanta të trashëgimisë shqiptare. Nga fusha juridike, përveç studimit monografik për Kanunin e Lekë Dukagjinit, botuar më 1971, është bashkautor edhe i dy veprave monografike: "Pozita e gruas në Kosovë, me një vështrim të posaçëm në të drejtën zakonore" dhe "Kriminalistika e delikucencës së të miturve", pastaj i një varg shqyrtime, artikujsh dhe studimesh në gjuhën shqipe dhe serbokroate, frënge dhe angleze. Mori pjesë me referate e kumtesa në simpoziume të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, ku trajtoi problemet e së drejtës zakonore shqiptare, duke qenë njëri nga autorët kryesorë të kësaj fushe në shkencën juridike shqiptare. (Nerxhivane G. Dauti)

PUSTINA Agron (1944-). Mjek, ortoped, profesor universiteti. Lindi në Tiranë. Arsimin fillor dhe gjimnazin i kreu në Shkup. Po aty kreu dhe Fakultetin e Mjekësisë (1967). Specializoi në lëmin e ortopedisë në Bruksel. Mbaroi studimet pasuniversitare në Fakultetin e Mjekësisë në Zagreb (1975), ndërsa më 1979 po në këtë fakultet mbrojti edhe tezën e doktoratës. Ndërkohë zë punë në Klinikën Ortopedike në



AGRON PUSTINA

Prishtinë (1971), fillimisht u zgjodh asistent, pastaj docent, profesor inordinar dhe profesor ordinar i lëndës kirurgjia e përgjithshme dhe luf-tarake në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. U përjashtua me dhunë nga puna pas vitit 1990

dhe filloi punën në poliklinikën e vet private, duke vazhduar mësimdhënien në Fakultetin e Mjekësisë në kushte të jashtëzakonshme. Pas luftës për një kohë të gjatë ishte drejtues i bordit për edukim të vazhdueshëm në Ministrinë e Shëndetësisë të Kosovës. Mori pjesë në disa kongrese e simpoziume ndërkombëtare dhe publikoi një sërë punimesh shkencore, si autor dhe bashkautor. (Cen Bytyçi)

PUSTINA Nexhat (1926 -1982). Poet, mësues. Lindi në Dibër të Madhe. Kreu shkollën fillore në vendlindje, gjimnazin në Tiranë, kurse Shkollën e Lartë Pedagogjike në Shkup. Një kohë qe punonjës i financave në ministrinë përkatëse në Tiranë. Prej vitit 1945 punoi si mësues, fillimisht në fshatin Volkovi të Mavrovës. Më pas punoi si mësues në Shkup, Kërçovë, Strugë, Gostivar, Kumanovë dhe Tetovë. Punoi shumë edhe në zhdukjen e analfabetizmit në mesin e të rinjve shqiptarë të Maqedonisë. Është njëri ndër poetët e parë shqiptarë në Maqedoni. Vargjet e para i botoi në gazetata dhe revistat e kohës: "Rilindja", "Jeta e re", "Zëri i rinisë", "Shkëndija", "Flaka", "Jehona" etj. Botoi përmbledhjet: "Zë bilbili, lule maji" (1969), "Zëri në shtrëngatë" (1972), "M'i vjedhin gurët" (1977) dhe "Këngë rebele" (1981). Një përmbledhje poetike iu botua pas vdekjes. Poezia e tij ishte me porosi kombëtare, ndaj u përdoq nga zyrtarët e sistemit komunist. (Fatmir Sulejmani)

PUSTINA Remzi (1914-1986). Mësimdhënës, veprimtar i arsimit. Lindi në Dibër, shkollën fillore dhe kolegjin amerikan "Harry Fultz" e kreu në Tiranë. Fillimisht ishte drejtor gjimnazi në Tiranë. Ishte ndër arsimtarët dhe themeluesit e shkollave të para shqipe të Dibër dhe në Tetovë, udhëheqës i grupit të arsimtarëve për themelimin e gjimnazit të parë në Tetovë, ku punoi deri në vitin 1954. Për shkak të aktivitetit të tij atdhetar, u pushua nga puna dhe u burgos.

Pas lirimt nga burgu punoi në disa ndërmarrje në Shkup. Përveç shqipes, ai ishte njohës i mirë i gjuhës angleze dhe italiane. Përtheu në shqip librat “Robinson Kruzo” dhe “Misteri i Luvrit”. La në dorëshkrim një fjalor shqip-anglisht, libra për fëmijë etj. (Myqereme Rusi)

PUSHKA Asllan (1943-2013). Gjeograf, profesor universitar. Lindi më 1943 në Pejë, ku kreu shkollën fillore dhe të mesmen. Studimet për gjeografi i mbaroi në vitin 1967, kurse



ASLLAN PUSHKA

magjistroi më 1970 në Universitetin e Zagrebit. Në po të njëjtin universitet mbrojt edhe doktoratën në vitin 1975. Punoi në departamentin e gjeografisë të Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore të Universitetit të Prishtinës (UP), ku ishte shef i katedrës, kryetar i Shoqatës së Gjeografëve të Kosovës dhe i Lidhjes së Shoqatave të Gjeografëve të Jugosllavisë. Për shumë vjet ligjëroi lëndën e gjeografisë ekonomike. Mbajti mësim edhe në Fakultetin Ekonomik dhe Filozofik të UP-së. Disa herë ka qëndruar për specializime në Gjermani. Në cilësi të profesorit të ftuar ka mbajtur ligjërata në universitete të ndryshme, në Bon, Hajdelberg, Sofje, Tiranë, Zagreb, Lubjanë etj. Mori pjesë në shumë simpoziume, seminare, kongrese, konferenca dhe tryeza shkencore. Opusi i tij profesional dhe shkencor është shumë i gjerë. Ka botuar disa tekste shkollore të gjeografisë për tri nivelet shkollore (fillor, të mesëm dhe universitar) dhe monografitë: “Metodat kuantitative në gjeografi” (1981), “Gjeografia agrare” (2000), “Aspekte gjeopopullative në Kosovë dhe rreth saj” (2000), “Aspekte gjeosociale dhe gjeoekonomike në Kosovë” (2002), si dhe punime të shumta profesionale e shkencore të publikuara në revista të ndryshme brenda dhe jashtë vendit. (Ibrahim Ramadani)

PUSHKOLLI Fehmi (1937-). Historian. Lindi në fshatin Katunishtë të Llapit. Shkollën fillore e kreu në Podujevë, ndërsa Shkollën Normale e mbaroi në Prishtinë. Studimet për histori i kreu në degën e historisë të Fakultetin Filozofik të Prishtinës. (1967). Po në Prishtinë kreu edhe studimet pasuniversitare dhe mbrojt tezën e doktoratës (1977). Në periudhën 1965-1970

ishite mësimdhënës në Shkollën Normale dhe në Shkollën e Bibliotekarisë në Prishtinë. Në vitin 1970 filloi të punojë në Entin e Historisë së Kosovës. Në periudhën 1973-1985 ishte redaktor i edicionit “Në flakën e revolucionit” (shqip dhe serbisht), pastaj ishte kryeredaktor i revistës së historianëve të Kosovës “Horizontet e historisë”. Me referate dhe kumtesa mori pjesë në shumë tubime shkencore të historianëve në Kosovë e në ish-Jugosllavi dhe udhëhoqi disa projekte shkencore në Institutin e Historisë. Ishte bashkautor i planeve dhe të programeve të historisë për shkollë fillore dhe të mesme më 1968, 1974, 1985 dhe 1990. Botoi një sërë veprash studimore dhe monografike, tekste shkollore dhe një numër artikujsh shkencor në revista të ndryshme. Disa nga veprat e tij të botuara janë: “Programet e mbrojtjes kombëtare shqiptare të Kosovës prej Lidhjes së Prizrenit deri të Kuvendi i Kaçanikut” (1991), “Arti ushtarak i gjeneral Boletinit” (1996), “Salih Gjinofci: sekretar i Shtabit të Brigadës së Drenicës në Ushtrinë Kombëtare për Mbrojtjen e Pavarësisë së Kosovës” (1996) “Llapi gjatë historisë” (1998), “Zahir Pajaziti, Hero i Kombit” (2001), “Mehë Uka madhështor” (2003) etj. (Sulltane Ukaj)

PUSHTIMET E STEFAN NEMANJËS (1168-1196). Ngritja e Stefan Nemanjës në krye të zhupanisë së Rashës (1168-1196) dhe kriza që kishte përfshirë Bizantin, ndikuan dukshëm në ndryshimin e hartës politike të Ballkanit. Ekspansionet më serioze të shtetit të Rashës nisën pas betejës së Pantinës më 1168, përkatësisht pas vdekjes së perandorit bizantin, Emanuel I Komneni (1180). Së pari u zgjerua në Rashë, ndërmjet Moravës së Madhe dhe Moravës Perëndimore, në Kosovë (Llap e Hvosno). Deri në vitin 1185 rrënoi qytetin e Danjës (Vau i Dejës), Shkodrën, Shasin, Ulqinin etj. Pas vitit 1189 pushtoi Tivarin. Siç bën të ditur biografia e Shën Savës kushtuar babait, Nemanja “mori nga bregdeti vendin Zeta me qytete; nga Rabani, të dy Pultët, ndërkaq nga toka greke mori Patkovën, Podrimën, Sitnicën, Labin dhe Lipjanin”.

Më 1190, duke i shfrytëzuar konfliktet e Bizantit me mbretin Barbarosa, rasanët pushtuan Gradecin (Pollog i Epërm), Leshkokun (Pollog i Poshtëm) dhe Shkupin. Këto pushtime të Nemanjës u bënë kur mbreti Barbarosa, duke kaluar nëpër tokat bizantine, shkaktoi trazira

të mëdha brenda Perandorisë. Ai kërkoi nga Barbarosa që t'ia njihte të gjitha pushtimet paraprake. Por, kur Barbarosa vdiq ndërkohë (10 qershor 1190), perandori bizantin Isaku II Ëngjell (1185-1195) sulmoi Nemanjën dhe e mundi rëndë në betejën e Moravës (1190).

Kjo disfatë e kishte detyruar Nemanjën t'ia dorëzonte Bizantit të gjitha tokat e pushtuara gjatë luftërave të fundit, para vitit 1190. Më pastaj shteti i tij do të rikthehet në tokat atërore, që shtriheshin vetëm në Zhupën e Rashës. (Jahja Drançolli)

Q

Qafa e Duhlës. Qafë malore në skajin jugperëndimor të maleve të Carralevës, në verilindje të fshatit Duhël, në lartësi mbidetare 858 m. Është e ndërtuar në sedimentet flishore (mergelë, alevrolite, ranorë) të kretës së sipërme dhe është e mbuluar relativisht mirë me bimësi, kryesisht me dushk. Përmes Qafës së Duhlës kalon rruga që lidh Rrafshin e Dukagjinit (Prizrenit) me atë të Kosovës (Prishtinës), e cila degëzohet me lidhjet rrugore me vendbanimet e Drenicës dhe vendbanimet kodrinore të Suharekës. Në të kaluarën edhe rruga e vjetër, e cila lidhte bregdetin shqiptar me brendinë e Gadishullit Ballkanik kalonte nëpër Qafën e Duhlës. (Valbon Bytyçi)

Qafa e Kullës. Qafë malore me lartësi 1,795 m në malin Zhleb të Bjeshkëve të Nemuna, e përbërë nga shkëmbinj gëlqerorë e dolomitorë dhe e mbuluar me vegjetacion të bujshëm, vendkalim kufitar Kosovë-Mali i Zi, përmes të cilit kalon rruga e rëndësishme automobilistike rajonale e asfaltuar, që lidh qytetin e Pejës (Kosovë) me qytetin e Rozhajës (Mali i Zi), përmes Vitomicës, Firzës e Radavcit. Rrugë pitoreske, por tejet gjarpërore dhe me pjerrtësi relativisht të madhe, përgjatë gjysmës së rrugës nga Ujërat e Savës deri te Qafa e Kullës gjatë dimrit shpesh bëhet e pakalueshme dhe e mbyllur për qarkullim. Përmes kësaj rruge është mundësuar qasja te Burimi i Drinit të Bardhë, afër Radavcit, i cili buron në rrëzën e malit Rusolia dhe paraqet një monument natyror karstiko-hidrik të rëndësishëm dhe një vend rekreativ-turistik mjaft të vizituar. (Vahdet Pruthi)

Qafa e Livadhut të Shehut. Qafë malore në Karadakun e Preshevës. Lartësia mbidetare 780 m. Që nga kohët e lashta ka shërbyer si

kalim natyror për karvanët tregtarë prej lindjes në perëndim dhe anasjelltas. Sot, bashkë me qafën e Muçibabës, mundëson komunikimin mes Luginës së Preshevës dhe Anamoravës në Kosovë. Qafën e përshkon magjistralla automobilistike rajonale M25, e cila lidh Preshevën me Gjilanin. Pyjet, livadhet, ajri i pastër dhe rruga e asfaltuar e kanë shndërruar këtë zonë në një pikë të rëndësishme të pushimeve familjare. (Arsim Ejupi)

Qafa e Merdarit. Shtrihet në verilindje të fushëgropës së Llapit, formimi i së cilës është kushtëzuar nga shkëputja tektonike gjatësore. Bën pjesë në degëzimin e Dumnicës, në sektorin verior të pellgut të Llapit dhe i takon pragut strukturor flishor me relief kodrinor midis Metehisë në perëndim dhe Herticës në lindje. Ndërtohet tërësisht prej shkëmbinjve flishorë dhe është modeluar në një strukturë monoklinale, me rënie lindore. Paraqet një monoklinal të kushtëzuar prej shkëputjes tektonike të Dumnicës, të Merdarit e deri në Përpellac. Nëpër këtë qafë kalon rruga më e shkurtër, që e lidh Kosovën me Serbinë. (Shpejtim Bulliqi)

Qafa e Morinës. Qafë malore në perëndim të Gjakovës me lartësi mbidetare 567 m. Lidh Kosovën me Shqipërinë, përkatësisht Gjakovën me qytetin e Bajram Currit. Në ndërtimin e saj gjeologjik marrin pjesë kryesisht shkëmbinj të ultrabazikë të masivit ultramafik të Gjakovës dhe shkëmbinj të moshës triasike të Bjeshkëve të Nemuna. Është krijuar nga kontaktin litologjiko-tektonik i të dy llojeve të shkëmbinjve. Nëpër Qafën e Morinës dikur kanë kaluar rrugët më të rëndësishme tregtare nga Stambolli deri në Shkodër. Deri në ndërtimin e hidrocentralit

në Vaun e Dejës dhe në Fierzë në Shqipëri, me këtë rrugë përgjatë bregut të Drinit mund të lidheshin skelet e Adriatikut dhe Shkodra me Kosovën deri në brendi të Gadishullit Ballkanik. Historikisht ishte rrugë karvanësh, të cilët merrnin drejtimin nga Kosova për në Shqipëri, nëpër Malësi të Gjakovës, Mirditë dhe më tej Shkodër, Lezhë, Durrës etj. dhe anasjelltas. Rruga kalohej me shumë vështirësi, për shkak vështirësive atmosferike dhe mungesës së infrastrukturës. Tani Qafa e Morinës ka karakter lokal. Korridorin “Adriatik-Alpe”, që parashihet të përshkojë trajektoren Shëngjin-Shkodër-Bajram Curr-Tropojë-Qafë e Morinë-Gjakovë, si infrastrukturë rrugore me rol të veçantë në nxitjen e bashkëpunimit midis trevave të shkëputura e të izoluar shqiptare, do të lidhet me superstradën e ardhshme “Adriatik-Jon”. (Nesim Vala)

QAFA E PËRPELLACIT. Qafë malore në verilindje të fushëgropës së Llapit, rreth 13 km në veri të Podujevës. Gjendet ndërmjet Kërtokut dhe Përpellacit, me lartësi mbidetare 876 m. Paraqet prag strukturor të ndërtuar nga shkëmbinj të flihorë të kretakut dhe karakterizohet me relief kodrinor-malor. Qafa është kushtëzuar nga shkëputjet tektonike dhe paraqet një monoklinal. Mbulesa bimore përfaqësohet nga kati i dushkut. Nëpër këtë qafë kalon rruga që lidh territorin e Kosovës me Serbinë, përkatësisht me banjën e Kurshumlisë. (Shpejtim Bulliqi)

QAFA E PREVALLËS. Qafë malore në Malet e Sharrit, shtrihet ndërmjet malit Oshlak dhe Malit të Madh. Lidhet me Prizrenin përmes kanionit të Lumëbardhit të Prizrenit (28 km). Qafa e Prevallës paraqet ujëndarësin topografik ndërmjet detit Egje dhe Adriatikut, përkatësisht Lumëbardhit të Prizrenit dhe të Lepencit. Lartësia mbidetare arrin 1,515 m. Peizazhin e dominojnë pyjet dhe kullosat. Shpati verior është marrë nën mbrojtje që nga viti 1960, si rezervat natyror, për të mbrojtur pishën *pinus heildreichii*. Është e njohur si qendër turistike e skijimit dhe e rekreacionit. (Selim Qevani)

QAFA E PRUSHIT. Qafë malore në malet e Hasit, me lartësi mbidetare 651 m. Ndodhet 9 km në jug të Gjakovës dhe lidh qytetin e Krumës dhe Kukësin me këtë qytet. Ka origjinë tektoniko-erozive. Është ndërtuar nga shkëmbinj ultrabazikë dhe është e mbuluar nga

një bimësi e varfër e shkurreve. Në të kaluarën ishte vend kryqëzimi i lidhjeve qarkulluese të shumta të karakterit rajonal dhe ndërajonal ndërmjet detit Adriatik, Shkodrës, Sanxhakut, Shkupit, Selanikut, Stambollit dhe qendrave të tjera të Europës Juglindore. Në antikitet kalonte nëpër këtë qafë një pjesë e rrugës “Via de Zenta”, që ishte njëra ndër rrugët kryesore të Ballkanit, prej Shëngjinit nëpër Prizren, pastaj nga Nishi deri në Konstandinopojë. Një pjesë e kësaj rruge te Vau-Spas ndahej në dy drejtime, njëri në drejtim të Prizrenit dhe tjetri nëpër Luginën e Krumës-Golaj-Letaj-Qafë Prushi-Gjakovë-Pejë. Stacion karvanësh, vend i fortifikuar, Qafa e Prushit ka gjasë të jetë vazhdim i emrit të fisit ilir Pirustëve-Pirustea. Nëpër këtë qafë kalon ndikimi i klimës mesdhetare në Rrafshin e Dukagjinit, si dhe lidhja me “Rrugën e Kombit”. (Nesim Vala)

QAFLESHI Mulla Bahtijar (1905-1979). Titullar i fesë islame. Lindi në fshatin Bellobrad të Opojës. Fillimisht mbaroi mejtepin në fshatin Brrut, kurse më pas ndoqi mësimet në Medresenë e Bresanës. Më 1938 u emërua imam në xhaminë e fshatin Bellobrad, detyrë që e kreu deri në vitin 1953. Më 1941 Opoja u bë komunë më vete dhe kryetar i parë i saj u zgjodh mulla Bahtijari. Ishte pjesëmarrës në kuvendin themelues të Lidhjes së Dytë të Prizrenit dhe në Asamblenë e Përgjithshme në Tiranë. Në vitin 1953 u dënua me 8 vjet heqje lirie, dënim që e vuajti në burgun e Nishit. Për shkak të presionit të vazhdueshëm politik, pas daljes nga burgu jetoi tërësisht i izoluar, deri në vdekje. (Resul Rexhepi)

QAHILI Eshref (1960-). Pikturor. Lindi në Rahovicë të Preshevës. Kreu Shkollën e Mesme të Artit në Pejë, Fakultetin e Arteve, drejtimi i pikturës, më 1983, në Prishtinë. Mbaroi studimet pasuniversitare në të njëjtin fakultet, më 2007. Është autor aktiv dhe ka hapur një sërë ekspozitash personale: në Galerinë “Ars” në Prishtinë (1992), në Galerinë “Cairo’s” po në Prishtinë (1993), në Galerinë “Apollonia” në Gjilan (1993), në Galerinë “Rada” në Prizren (1996), pastaj në Galerinë “Hani i 2 Robertëve”



ESHREF QAHILI

në Prishtinë dhe në Galerinë e Arteve të Kosovës (2002). Hapi edhe ekspozita personale edhe jashtë Kosovës, si në Galerinë “Kulla e Balshajve” në Ulqin (2005), në Varna të Bullgarisë (2006), në Muzeun e Artit Bashkëkohor në Shkup (2007), në “Maission des Association Du 7^{eme}” në Paris (2012) dhe në Galerinë “Espace 26 Denfert Rochereau” po në Paris, ndërsa dy vjet më vonë ekspozoi në Galerinë e Universitetit Lindor Mesdhetar në Qipro. Mori pjesë në shumë ekspozita kolektive brenda dhe jashtë Kosovës, si në ekspozitën “Arti Bashkëkohor i Kosovës” në Vjenë më 2006 dhe në Paris më 2007, pastaj “Java e Kulturës Kosovare” në Tiranë më 2008 dhe në dy ekspozita kolektive po në Paris, në “Lart nous uni”, në Galerie Colette Dubois (2009) etj. Është fitues i një sërë çmimesh, siç është ai i Sallonit XXIV Vjeshtor (1997 dhe 1998) në Prishtinë, pastaj mori çmimin e manifestimit kulturor “Flaka e Janarit” në Gjilan (1998), çmimin “Gjon Mili” në Prishtinë (2005), atë të Sallonit të Nëntorit në Prishtinë etj. Është profesor i lëndës së vizatimit në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. (Rexhep Ferri)

QARKU LETRAR. Qarku letrar është kategori tipologjike e historiko-letrare që përcakton tipologjikisht e përshkruan historikisht fenomene letrare, të lidhura me një ambient e me kulturën e tij. Termi qark letrar e qarku si kategori e njohin natyrën kulturore-letrare të periodizimit letrar dhe vihen përballë termave tradicionalë periodizues, të cilët historia e letërsisë i merr nga historia etnike, kulturore, sociale apo politike. Autorët e një qarku i mbajnë bashkë vetitë e përafërta të veprave të tyre, të kthyer në ide e në prosede. Edhe pse këto veti marrin trajtën e konstantave që lidhin autorët, boshti i konstantave letrare asnjëherë nuk i përjashton veçantitë e autorëve. Prandaj, qarku letrar nuk i fshin diferencat e sensibiliteteve, të stilit e të ideve të autorëve, por konstituohet në nyja të përbashkëta. Tipologjizimin e letërsisë shqipe sipas pikëpamjes së qarkut, pikëpamje themelore të punës e bëri Eqrem Çabej, te “Për gjenezën e literaturës shqipe” (1938/1939). Ai skajoi: Qarkun katolik të Shqipërisë Veriore, Qarkun italo-arbëresh, Qarkun ortodoks të Shqipërisë Jugore, Literaturën kombëtare të shekullit XIX, në një tipologji kulturore-letrare, në të cilën qarqet lidhen me vendin e me kohën, por që

përfundimisht derdhen në shtratin e literaturës nacionale. Në letërsinë e në kërkimet letrare moderne shqipe është bërë i njohur Qarku letrar i Prishtinës, i cili përbën një fenomen, një kulturë letrare e një shkollë poetike, të lidhura tashmë si trashëgimi letrare e tij. Qarku i Prishtinës u shfaq në fundin e viteve '60 e në hyrje të viteve '70 të shekullit XX dhe u rrit mbi traditën kulturore, letrare e nacionale, si dhe zbuloi dijet moderne europiane e perëndimore përgjithësisht. (Kujtim M. Shala)

QARKULLIMI I MONEDHAVE NË DARDANI. Dardania njohu shumë herët ekonominë monetare. Monedhat kanë qarkulluar në periudhën protohistorike, por në Kosovë nuk është evidentuar numër i madh i tyre. A. Evans përmend gjetjen e shumë monedhave greke, maqedone, ilire dhe kelte në këtë hapësirë, por duket se pjesa më e madhe e tyre është shkrirë nga artarët dhe ka përfunduar në koleksionet private jashtë vendit, siç është thesari i monedhave të Damastionit nga Janjeva. Në kuadër të territorit dardan apo në afërsi të tij gjendej qyteti-minierë Damastion, i cili farkoi monedha nga shek. IV p.e.r., tetradrahme dhe drahme prej argjendi. Paralelisht dhe pas shuarjes së punëtorisë së Damastionit e deri në pushtimin e plotë romak të Dardanisë, qarkulluan monedha të Dyrrahut dhe të Apolonisë së Ilirisë, ndërsa nga fundi i shek. II p.e.r. hyri në qarkullim edhe denari republikan romak. Gjatë periudhës së sundimit të Perandorisë Romake qarkulluan monedhat e gati të gjithë perandorëve romakë dhe të familjeve të tyre, gjë që dëshmon edhe për potencialin tregtar-zejtar të trevës dardane. Gjatë sundimit të perandorëve romakë Trajan dhe Hadrian janë prerë edhe monedha për përdorim lokal, me mbishkrim në shpinë “Dardanici”. Pas ndarjes së Perandorisë Romake në të Lindjes dhe të Perëndimit (395) u përdor monedha e Perandorisë Lindore dhe nga kjo fazë dominuan monedhat e kohës së perandorit Justinian. Pas sundimit të Justinianit monedhat janë të rralla, deri në ardhjen në pushtet të Dinastisë së Komnenëve. (Fatmir Peja)

QATOVIQ Hilmi (1933-2017). Piktur. Lindi në Rozhajë. Kreu Shkollën e Mesme të Artit në Shkup, ndërsa studimet për pikturë monumentale në Akademinë e Arteve

Aplikative në Beograd (1957). Ishte profesor i pikturës në Fakultetin e Arteve në Prishtinë deri në vitin 1999, kur u largua nga Kosova. Hapi ekspozita personale që nga vitet '50: në Novi-Pazar (1957), në Podgoricë (1959), në Prishtinë (1969, në Zagreb (1971), në Shkup (1972), pastaj në Novi-Sad, Zagreb, Beograd, Lubjanë, Podgoricë dhe në qendra të tjera të ish-Jugosllavisë. Mori pjesë në të gjitha ekspozitat e organizuara nga Shoqata e Artistëve Figurativë të Kosovës dhe në veprimtari të tjera artistike. Ka ekspozuar edhe jashtë vendit: "Ballkani, zonë e paqes" në Bukuresht, pastaj në Këln, Paris, Lion, Shtutgart, Damask, Aman, Ankara etj. Tematikë e pikturës së tij është peizazhi dhe motivet e ambientit kosovar, apo të vendlindjes. Në të gjitha punimet dominon fryma realiste, me nuanca të lirizmit poetik. Është fitues i disa çmimeve profesionale dhe mirënjohjeve publike. (Hivzi Muharremi)

QAZIMI Qazim (1946-). Teolog islam, mësimdhënës. Lindi në fshatin Llovcë të komunës së Gjilanit. Shkollën fillore e kreu në Pogradje, ndërsa të mesmen në Medresenë "Alaudin" në Prishtinë. Studimet i vazhdoi në Bagdad, në Fakultetin Filozofik, në degën e letërsisë dhe të shariatit (1972). Pas diplomimit punësohet në Medresenë e Mesme "Alaudin" në Prishtinë, si mësimdhënës i lëndëve gjuhë arabe dhe tefsir. Në periudhën 1991-1999 ishte drejtor i Medresesë. Kreu studimet pasuniversitar dhe mbrojti disertacionin e doktoratës (2001) në degën e letërsisë shqipe të Fakultetit të Filologjisë të Universitetit të Prishtinës. Që nga hapja e Fakultetit të Studimeve Islame në Prishtinë (1992), ligjëroi lëndën e gjuhës arabe dhe një mandat ushtroi edhe detyrën e dekanit (2012-2014). Mori pjesë në shumë seminare, simpoziume e konferenca vendore e ndërkombëtare dhe botoi studime e kontribute të shumta në periodikun e Bashkësisë Islame të Kosovës. Përveç botimit të teksteve shkollore, është edhe autor i disa monografive: "Ndikime orientale në veprën letrare të Naim Frashërit" (1996), "Jeta dhe vepra letrare e Muhamed Çamit" (2002) etj. (Ramadan Shkodra)

QAZIMI Ridvan (1964-2001). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare për Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë (UÇPMB), dëshmor. Lindi në fshatin Tërrnoc të Bujanocit. Ishte aktivist i degës së Shoqatës "Nënë Tereza", ku dha kontribut me

ndihma materiale për popullatën e zhvendosur në Kosovë. Më pas ndihmoi formimin e njësiteve të armatosura për Luginën e Preshevës. Në mars të vitit 2000 u zgjodh anëtar i Këshillit Politik për Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc. Në shtator të po atij viti u emërua komandant i Brigadës 112 "Sherif Jonuzi", e cila veprroi në Zonën Operative të Bujanocit. Mori pseudonimin "Komandant Lleshi". U emërua edhe anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të UÇPMB-së. Në bisedimet e zhvilluara me përfaqësuesit e qeverisë serbe, kryesonte grupin negociator të palës shqiptare. Pas arritjes së marrëveshjes për demilitarizim, më 24 prill 2001 u vra në vendin e quajtur Guri i Gjatë në Tërrnoc. Përfaqësuesit e shqiptarëve akuzuan forcat serbe për vrasjen e tij. (Fehari Ramadani)

QEHAJA Nexhat (1956-). Inxhinier i makinerisë, profesor universiteti. Lindi në Rogoçicë të Kamenicës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa të mesmen dhe Fakultetin Teknik në Prishtinë (1980). Studimet pasuniversitare i kreu në Fakultetin e Makinerisë dhe të Anijendërtimtarisë në Zagreb, ndërsa doktoroi në Fakultetin e Makinerisë të Universitetit të Prishtinës (UP) (2006). Punoi në disa ndërmarrje, kurse në vitin 1981 u zgjodh asistent në Fakultetin e Makinerisë të UP-së. Në vitet vijuese u avancua në titujt e tjerë universitarë. Si bashkautor botoi tekstin universitar "Materialet e makinerisë" (1998) dhe hartoi disa dispensa për lëndët mësimore nga fusha e teknologjisë së materialeve dhe të përpunimit të tyre. Mori pjesë në simpoziume dhe konferenca të ndryshme shkencore dhe profesionale dhe botoi disa punime nga fusha e interesimit të tij shkencor. Kreu edhe disa projekte të lëmit të makinerisë. Është mësimdhënës në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike të UP-së. (Hysni Osmani)

QEHAJA Ramadan (1942-). Gjeneral i Armatës Jugosllave, ekspert i çështjeve ushtarake dhe të sigurisë. Lindi në Rogoçicë të Kamenicës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, shkollën e mesme ushtrake në Sarajevë, ndërsa Akademikën e Forcave Tokësore në Beograd (1966). Kreu detyra të rëndësishme të nivelit taktik-operativ dhe strategjik në forcat e armatosura të ish-Jugosllavisë. Në fillim të vitit 1990 u dekretua në gradën e gjeneralmajorit, si shef i Shtabit të Përgjithshëm të Mbrojtjes Territoriale të



RAMADAN QEHAJA

Kosovës. Ligjëroi lëndën e mbrojtjes popullore në Universitetin e Prishtinës (1969-1988). Botoi dy tekste universitare për këtë lëndë. Pas vitit 1999, pas demilitarizimit të UÇK-s, kreu detyrën e komandantit të Akademisë së Mbrojtjes të Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK) dhe më pas ishte drejtor i shërbimeve mbështetëse të Shtabit të Përgjithshëm të TMK-së dhe këshilltar i koordinatorit të UNMIK-ut për TMK-në (2001-2002). Në periudhën 2005-2006 ishte këshilltar për çështje të sigurisë i kryeministrit të Kosovës. Në vitin 2011 nga Kuvendi i Kosovës u emërua mbikëqyrës shtetëror në Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Është autor i librave “Çështjet e sigurisë nacionale të Kosovës” (2004) dhe “Të bësh një karrierë ushtarake” (2012) (Fehmi Rexhepi)

QEHAJIQ (Çehajic) Ekrem (1921-?). Aktor. Lindi në Nish, Serbi. Shkollën fillore dhe të mesme të aktrimit i kreu në vendlindje. Më 1955 u pranua si aktor në ansamblin e dramës serbe të Teatrit Popullor Krahinor në Prishtinë. Në këtë teatër deri në fund të viteve '90 luajti në shfaqje dhe role të ndryshme, si: “Tregtari i Venedikut”, “Nëna Kurajë”, “Topi laraman”, “Deputeti i popullit”, “Zeja e zonjës Uoren”, “Bora dhe zjarri”, “Fëmija i huaj”, “Zonja ministreshë”, “E shoqja e Hasan Agës”, “Përralla për Mbretin dhe Bariun”, “Fizikanët”, “Hajni i shtetit”, “Mica dhe Mikica”, “Gjaku i papastër”, “I ndjeri”, “Duart e ndyta” etj. Luajti gjithashtu në disa filma dhe drama televizive. Për kreacionet artistike u nderua me çmime dhe mirënjohje. Në vitin 1999 i humb çdo gjurmë. (Bekim Lumi)

QENA Leze (1945-). Aktore. Lindi në Prizren, ku kreu shkollën fillore dhe të mesme. E filloi karrierën prej aktoreje në vitin 1954. U veçua për shkathtësitë interpretuese në shfaqjet e zhanrit komedi. Përgjatë karrierës së saj 50-vjeçare si aktore teatri në Teatrin Popullor Krahinor (TPK) interpretoi një sërë rolesh. Kreacionet më të suksesshme i dha në shfaqjet: “Borëbardha dhe shtatë shkurtabiqët”, “Pjata e drunjtë”, “Kur është gruaja memece”, “Hanka”,



LEZE QENA

“Miu në xhep” etj. Interpretoi edhe role dramatike, në mesin e të cilave u shqua për rolin e saj të Ana Frankut te “Ditari i Ana Frankut”. Në role kryesore si dhe të tjera interpretoi edhe në këto shfaqje: “Fjala është për banesë”, “Kvej Llan” (shfaqje në gjuhën serbe), “Kushëriri prej Amerike”, “E shoqja e Hasan Agës”, “Familja e pikëlluar”, “Autobiografia”, “Nuk marthohem me parë”, “Tartufi”, “Duart e papastra”, “Othello”, “Antigona”, që të gjitha të vendosura në skenën e Teatrit Popullor Krahinor gjatë viteve '60. Më pas renditen shfaqjet e inskenuara gjatë viteve '70: “Perkolgjinajt”, “Të ngujuarit”, “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”, “Hotel Kashta”, “Zëri i ndërgjegjes njerëzore” etj. Interpretoi edhe në seriale dhe projekte të tjera televizive e filmike. Në periudhën e pasluftës (1999) është paraqitur në shfaqjen “Dashnori i nënës sime”, ndërsa për shumë vjet është identifikuar me rolin e gjyshes në serialin televiziv “Familja moderne” në Radiotelevizionin e Kosovës (2002-2010). (Arian Krasniqi)

QENA Melihate (1945-). Regjisore, aktore. Lindi në Gjakovë. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Mitrovicë. Kreu studimet për aktrim në Akademinë për Teatër, Film, Radio dhe Televizion në Beograd (1971). Edhe pse mbaroi studimet e aktrimit, më shumë njihet si regjisore. Fillimisht u diplomua me rolin e “Lavires” në shfaqjen “Lavirja e denjë për respekt” në Beograd dhe më pas luajti në



MELIHATE QENA

Teatrin e Prizrenit shfaqjet “Koloneli Shaber” dhe “Fëmija i huaj” etj. Më 1996 në Teatrin “Dodona” luajti në shfaqjen “Dashuritë e Xhorxh Uashingtonit” dhe pas luftës “Grafitet” në Teatrin Oda, “Shtëpia e Bernarda Albës”, “Orestia”, “Fizikanët” dhe “Nana dhe fëmija” në Teatrin Kombëtar të Kosovës, si dhe shfaqjet “Këmisha e gjakut” në Teatrin “Loja” dhe “Fedra” (Enona) në Teatrin “Dodona”. Si aktore luajti edhe në disa nga shfaqjet e saj me kukulla. Prej vitit 1974 dhe deri më 1990 punoi si regjisore në redaksinë e emisioneve për

fëmijë të Televizionit të Prishtinës. Më 1983, në Teatrin e Prizrenit bëri regjinë e shfaqjes “Menaxheria e qelqtë”, në Teatrin “Dodona” vuri në skenë shfaqjet “Ditë vere” (1993) dhe “Unë në botën e Talisë” (1994). Nga viti 1988 dhe këndej bëri regjinë e shumë shfaqjeve me kukulla dhe të shfaqjeve për fëmijë, kryesisht në Teatrin “Dodona”, ndër të cilat duan përmendur: “Rosak baltaku”, “Ëndrra e vajzës dhe Babadimri”, “Minuku lozonjar”, “Posta e porositur”, “Picrraku”, “Përralla me lara”, “Ambrozio shfaros kohën”, “Një minak për nipin Mak”, “Goni Trazovaçi”, “Llamba magjike e Aladinit”, “Topi-hopi”, “Kësulëkuqja”, “Borëbardha dhe shtatë shkurtabiqët”, “Në dhomën katër me tre”, “Goni në fushën e minave”, “Princesha dhe dragoi”, “Pula kllaçë e Abës Loçkë”, “Pinokio”, “Vjollca magjike”, “Llamba magjike e Aladinit”, “Pylli është i të gjithëve”, “Doktori Ofmëdhemb”, “Cirku i lodrave” etj. Me shfaqjet e saj mori pjesë në shumë festivale. Në Festivalin e Teatrove të Kukullave “Xinxifillo” në Pogradec disa herë u nderua me çmimet kryesore. Më 2015, nga Ministria e Kulturës u nderua me çmimin kombëtar për vepër jetësore. (Bekim Lumi)

QENA Muharrem (1930-2006). Regjisor, aktor, dramaturg, kantautor. Lindi në Mitrovicë. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa të mesmen në Prishtinë. Studioi në Shkollën e Lar-



MUHARREM QENA

të të Filmit (dega e aktrimit filmik) në Beograd, më pas studioi për regji teatri në Akademinë për Film, Radio dhe Teatr po në Beograd. Më 1964, në Poloni, ndoqi një specializim disa muajsh për teatër. Krijimtarinë artistike e nisi si aktor dhe si asistent-regjisor më 1948 në Teatrin Popullor Krahinor të Prishtinës. Si regjisor (e diku edhe si aktor) në këtë teatër, në vitet '50 dhe '60 u paraqit në shfaqjet “Hani në rrugën kryesore”, “Martesa”, “Sikur t'isha djalë”, “Zhorzh Dandeni”, “Besa”, “Zullumqari”, “Zonja me kamelië”, “Studentët e përjetshëm”, “Ambrozio shfaros kohën” etj. Po aty, në vitet '70 krijoi shfaqjet “Përkolginajt” dhe “Njerëzit me shpresa të thyera”, ndërsa në vitet '80 shfaqjet “Milionerët”, “Orkidea” dhe “Mbikëqyrësi”, si dhe në fillim të viteve '90 shfaqjen “Lkeni i Hasit”. Me emrin

e tij lidhen edhe fillet e punës profesioniste në Teatrin e Mitrovicës dhe në Teatrin e Prizrenit. Në vitet 1954-1956, në Teatrin e Mitrovicës vuri në skenë shfaqjet “Besa”, “Burri i mashtruem”, “Vocrraku im”, “Mërgimtarët”, “Nuk martohem me pare”, “Loja e rastit dhe e dashunisë”, “Fejesa”, “Hani” dhe “Bashkëshortët” dhe më pas në vitet 1973-1974 në Teatrin e Prizrenit shfaqjet “Ambrozio shfaros kohën”, “Gishti para hunde” dhe “Koloneli Shaber”. Gjatë viteve '60 e '70, në Teatrin e Kombësive në Shkup inskenoi shfaqjet “Nita”, “Armiku i popullit” dhe “Bashkëshortët”. Prej vitit 1977 e tutje realizoi shfaqje në Teatrin Popullor të Gjakovës: “Fisheku në pajë”, “Besa”, “Monserati”, “Pushkët e Nënës Karrar”, “Pjata e drunjte”, “Vocrraku im”, “Oskar” dhe “Ambrozio shfaros kohën”, si dhe më 1988 në Teatrin e Pejës me shfaqjen “Zhorzh Dandeni”. Njihet edhe si aktor filmi (“Kapetan Lleshi”, “Kur pranvera vonohet”, “Lepuri me pesë këmbë”, “Proka” dhe “Kukumi”), si dramaturg (me dramën “Bashkëshortët”), si regjisor filmash televizivë dhe dokumentarë (1975-1985) në Televizionin e Prishtinës, si autor dramatizimesh e radiodramash, si dhe si kantautor i disa këngëve argëtuese. Kryevepra e tij në teatër është shfaqja “Erveheja” (1966). Shfaqja mori çmime si shfaqja më e mirë në festivalet prestigjioze teatrore të ish-Jugosllavisë. Për punën artistike si aktor dhe regjisor në teatër mori shumë çmime dhe mirënjohje nga institucionet e vendit dhe nga asociacionet e ndryshme profesioniste. (Bekim Lumi)

QENA Nebi (1977-). Gazetar. Lindi në Mitrovicë, shkollën fillore dhe të mesme i përfundoi në Prishtinë, ndërsa dy vjet të shkollimit parauniversitar i ndoqi në shkollën private angleze “Dean Close School” në Cheltenham (1996). Magjistroi për politikë kulturore në “Warwick University” në Britani të Madhe (2006). Filloi gazetarinë më 1997 në gazetën “Koha ditore”, ku raportoi për zhvillime të ndryshme në Kosovë gjatë periudhës së repressionin serb. Ishte njëri nga gazetarët që ndoqi daljen e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në skenë dhe në baza ditore raportoi eskalimin e luftës në Kosovë. Pas përfundimit të luftës, një kohë punoi në TV “Kohavision”, ndërsa në periudhën 2002-2005 ishte korrespondent i agjencisë France-Presse nga Prishtina. Më 2006 u emërua kryeredaktor i Televizionit të Kosovës, ndërsa nga viti 2007 deri në vitin 2015

ishite korrespondent dhe producent i agjencisë amerikane të lajmeve "Associated Press". Në vitin 2015 u caktua udhëheqës i produksionit televiziv të kësaj agjencie në Jerusalem, Izrael. (Ibrahim Berisha)

QENA Nehat (1936-2015). Gazetar. Lindi në Mitrovicë. Aty kreu shkollën fillore dhe të mesme, ndërsa studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Më 1965 u punësua lektor në të përditshmen "Rilindja", ndërsa më 1970 caktohet redaktor i faqes javore humoristike "Anza", ku punoi deri në vitin 1981, kur ndalohet botimi i kësaj faqeje. Ndërkohë caktohet redaktor i shtojcës për radio, televizion e film, punë që e kreu deri me ndërprerjen e daljes së "Rilindjes", përkatësisht "Bujkut". Për shumë vjet udhëhoqi rubrikën satirike "Satirikon". Gjatë punës në redaksinë "Rilindja", e më vonë në "Bujku", e gjejmë në detyra të ndryshme, si redaktor i fejtornistikës, redaktor i kulturës, etj. Mbas përfundimit të luftës punoi në "Koha ditore", fillimisht lektor, e më vonë edhe redaktor i shtojcës javore humoristike. Në moshë të rinisë u mor me teatër. (Zenun Çelaj)

QENA Rebeka (1974-). Aktore. Lindi në Prizren. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Prishtinë. Studimet për Aktrim i kreu më 1996 në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. Në Teatrin "Dodona" luajti në disa shfaqje me kukulla dhe në disa shfaqje për të rritur, si: "Iluzionet e dashurisë" (1993), "Kur kishe mujt me më pa qysh më kishe pa" (1994) etj. Në Teatrin "Oda" luajti në shfaqjen "Sikur kjo të ishte shfaqje" (2013). Në Teatrin Kombëtar të Kosovës punoi si asistente e regjisë dhe si aktore në shfaqje të ndryshme. Ka luajtur gjithashtu edhe në disa filma të shkurtër (Erson Zymberi)

QENA Xhevat (1932-2003). Aktor. Lindi në Mitrovicë, ku mbaroi shkollën fillore dhe të mesme. Në Teatrin Popullor Krahinor u angazhua që në vitin 1952. Gjatë karrierës së tij të gjatë prej aktori interpretoi në shfaqje të shumta të dramaturgjisë botërore dhe asaj shqipe, kryesisht në Teatrin Popullor Krahinor (TPK). Ndër shfaqjet më të njohura, ku interpretoi rolet më të dalluara në skenën e këtij teatri janë: "Nuk martohem me parë", "Shërbëtori i dy zotnive", "Koshtana", "Kryet e hudrës",



XHEVAT QENA

i Gjegjeut në shfaqjen "Sinkopa". Gjatë viteve '60 dhe '70 të shekullit të kaluar është paraqitur edhe në një numër të madh shfaqjesh, si: "Cubat", "Familja e pikëlluar", "Matura", "Të falat e sherifit", "Kur është gruaja memecë", "Lavirja e denjë për respekt", "Autobiografia", "Pylli", "Peripetitë e kohës", "Zonja me Kamelië", "Profesori Mamllok", "I ndjeri", "Paradoksi i Diogjenit", "Tartufi", "Vinetu", "Magjistartarja", "Hanka", "Erveheja", "Revizori", "Golgota", "Shtettrrethimi", "Njeriu i mirë nga Seçuani", "Makbethi", "Beselam, pse më flijojnë", "Besa e madhe", "Përqaftimi", "No pasaran", "Bregu i pikëllimit", "Martesa", "Garderobisti" etj. Interpretoi edhe në realizimet skenike të dramës serbe dhe të asaj turke, në kuadër të TPK-së, si në shfaqjet "Personi i dyshimtë", "Shpijuni". Për kreacionin e tij skenik, në takimet e teatrove "Joakim Vujiq", të mbajtura në Kragujevc (1966) u shpërblye me çmimin aktori më i mirë për rolin e tij të Selverit në shfaqjen "Dredhite e Shaptukut" të Molierit, me regji të Muharrem Qenës. U angazhua si aktor edhe në kinematografi, duke luajtur në filmat: "Uka i Bjeshkëve të Nemuna" (1968), "Si të vdiset" (1972), pastaj në filmat e regjisorit Ekrem Kryeziu "Gjurmët e bardha" (1980) dhe "Kur pranvera vonohet" (1980), "Proka" (1984) etj. Luajti edhe në seriale dhe projekte të tjera televizive. (Arian Krasniqi)

QENA-KAÇANIKU Antigona (1954-). Gazetare. Lindi në Prishtinë. Studioi për pikturë në Akademinë e Arteve të Universitetit të Prishtinës. Filloi gazetarinë në Radio Prishtinë dhe pastaj, me fillimin programit të dytë të Radio Prishtinës në vitin 1975, punoi si moderatore. Në Televizionin e Prishtinës punoi si prezentuese, spikere dhe gazetare. Shkroi tekste dhe intervista me krijues për revista dhe gazeta të ndryshme, si: "Kosovarja", "Zëri i rinisë", "Teuta", "Koha" etj. Më 1990 emigroi në Oslo të Norvegjisë, ku themeloi programin

në gjuhën shqipe "Radio Rilindja", ndërsa nga viti 2006 punon në RTK dhe përgatit emisionin televiziv "Pa skenar", në të cilin prezanton krijuesit e dikurshëm. Ka incizuar disa këngë argëtuese, të cilat më 2009 i përmbloodhi në një CD ("Kënga ime"). (Shaqir Foniqi)

QENDRA "MULTIMEDIA". Organizatë e pavarur kulturore, që merret me teatër, dramaturgjë dhe letërsi bashkëkohore. U themelua në prill të vitit 2002 në Prishtinë, nga dramaturgu Jeton Neziraj. Veprimtaria e saj është e shtrirë brenda dhe jashtë vendit. Në fushën e teatrit, gjatë një viti, i krijon dy deri në tri shfaqje për grupmosha të ndryshme, ndërkaq në fushën e letërsisë merret me botimin, përkthimin dhe promovimin e librave të autorëve të vendit dhe të huaj, të cilat promovojnë komunikimin dhe integrimin. Organizon edhe disa manifestime letrare. Me krijimet, bashkëprodhimet dhe veprimtaritë e saj artistike e kulturore ka pasur një sërë paraqitjesh ndërkombëtare në vende të ndryshme, si në Gjermani, Austri, Zvicër, Itali, Kroaci, Shqipëri, Serbi, Maqedoni etj. (Bekim Lumi)

QENDRA E STUDENTËVE, PRISHTINË. Institucion i arsimit të lartë për banimin, ushqimin, studimin dhe argëtimin e studentëve të Universitetit të Prishtinës. U themelua në vitin



QENDRA E STUDENTËVE NË PRISHTINË

1960, në disa konvikte-baraka. Gradualisht, ky institucion u shndërrua në qendër të rëndësishme të jetës akademike, kulturore-argëtuese dhe politike në Kosovë. Kishte pesë konvikte, tri pavijone, dy restorante, sallën e sportit dhe klinikën e studentëve. Në vitin 1981 ishte njëra nga vatrave kryesore të demonstratave dhe të lëvizjes studentore. Gjatë viteve '90 të shekullit të kaluar, me vendosjen e administrimit të

dhunshëm serb në Universitetin e Prishtinës, pushoi së vepruari edhe qendra e studentëve. Pas çlirimit të Kosovës (1999), kjo qendër u rivitalizua dhe u kthye në destinacionin e vet për studentët e Universitetit të Prishtinës. Qendra e Studentëve në Prishtinë ka shtatë konvikte me kapacitet prej 3,600 shtretërish, përfshirë edhe restorantin dhe një numër shërbimesh përcjellëse të standardit jetësor. Në konvikte pranohen vetëm studentët e rregullt, komuna e të cilëve është më larg se 25 km nga Prishtina. Fillon të funksionojë nga 1 tetori dhe përfundon më 30 qershor të vitit shkollor. (Hajrullah Koliqi)

QENDRA E TELEMJEKËSISË E KOSOVËS.

U themelua me iniciativën e kirurgut të mirënjohur kosovar nga Amerika, dr. Rifat Latifit, i cili përmes Fondacionit Kosovar për Zhvillim




QENDRA E TELEMJEKËSISË

min Mjekësor dhe Shoqatës Kosovare të Telemjekësisë, si dhe në bashkëpunim me institucionet relevante shëndetësore të Kosovës, kanë arritur që nga Agjencia Europiane për Rindërtim të sigurojnë mjetet financiare për fazën e parë të këtij institucioni të rëndësishëm shëndetësor. Inaugurimi zyrtar i kësaj Qendre u bë më 10 dhjetor 2002. Zhvillimi i saj është realizuar në disa faza dhe është përkrahur edhe nga donatorë të tjerë të rëndësishëm, edhe nga Departamenti Amerikan i Shtetit. Misioni kryesor i Qendrës së Telemjekësisë së Kosovës është përparimi i gjendjes shëndetësore të popullit në Kosovë e në rajon dhe krijimi i rrjetit të komunikimit elektronik shëndetësor (Health Virtual Network). Aktualisht, Qendra e Telemjekësisë e Kosovës është një institucion modern, i cili mundëson zhvillimin e programeve themelore të edukimit mjekësor në kuadër të

sistemit shëndetësor të Kosovës, shfrytëzimin e konsultimeve dhe bashkëpunimin telemjekësor rajonal dhe ndërkombëtar, si dhe krijimin e kapaciteteve njerëzore, të cilat do të udhëheqin dhe zbatojnë programet e telemjekësisë në spitalet e Kosovës dhe të rajonit. Deri tash në këtë Qendër janë mbajtur më shumë se 3,000 orë telekomunikime ndërkombëtare dhe rajonale, ku kanë kontribuar profesorë dhe ekspertë të fushave të ndryshme mjekësore të 42 universiteteve me renome, nga 16 shtete të ndryshme të të gjitha kontinenteve. (Avdyl Krasniqi)

QENDRA E TURIZMIT BREZOVICA. Qendër e njohur turistike, afër 12 km në jug të vendbanimit Brezovica (Shtërpcë), në anën veriperëndimore të Maleve të Sharrit. Është



QENDRA E SKIJIMIT NË BREZOVICË

një kompleks unik sportiv-rekreativ në lartësi mbidetare prej 900 m deri 2,500 m. Lidhet me rrugë të asfaltuar rajonale me Prishtinën (70 km), Shkupin (70 km) dhe Prizrenin (40 km). Rajoni i Brezovicës shquhet me peizazhe të bukura, male të larta, monumente natyrore gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike e biogeografike, burime dhe rrjedha ujore me ujë të ftohtë, me pyje shekullore, livadhe madhështore dhe kullota të pafundme përplot me lule mali e bimë shëruese, me lloje të rralla të shtazëve të egra etj. Pjesët e ulëta të Brezovicës karakterizohen me klimë të përshtatshme, ditët e ngrohta dhe netët e freskëta. Në pjesët më të larta mbretëron klimë alpine, kështu që mbulesa e borës mbetet e qëndrueshme edhe deri në 280 ditë. Shpeshherë pjesët e larta të Maleve të Sharrit edhe gjatë gushtit janë të mbuluara me borë, kështu që kushtet klimatike paraqesin mjedis ideal për turizëm dimëror, sportiv dhe rekreativ. Terrenet e

gjëra të skijimit të Brezovicës përbëhen nga një sistem prej pesë teleferikësh dhe pesë skiliftësh, ndërmjet të cilëve janë 16 km shtigje për të bërë ski, me gjatësi mesatare prej 3,000 metrash, të cilat janë shumë të përshtatshme për rrëshqitje të shpejta e të sigurta. Për këtë arsye në terrenet e skijimit në Brezovicë janë organizuar gara vendore e ndërkombëtare të sporteve dimërore. Kushtet natyrore të Brezovicës, përveç turizmit dimëror sportiv, mundësojnë edhe zhvillimin e turizmit veror, shëndetësor, të piknikut, të gjuetisë, të turizmit rezidencial, si dhe të alpinizmit. Për zhvillimin e turizmit, në vendbanimin e Brezovicës, afër rrugës kryesore, janë ndërtuar hotelet, "Narcis" e "Breza", me numër të konsiderueshëm të shtretërve, ndërsa afër terreneve të skijimit janë hotelet, "Molika" dhe "Sport Tours". Hotelet "Narcis" dhe "Breza" janë të lidhur me qendrën e skijimit me rrugë lokale të asfaltuar. Përgjatë kësaj rruge, në pjesën qendrore të saj, janë ndërtuar një numër i madh vilash private. Qendra e skijimit në Brezovicë hyn në radhën e qendrave të rëndësishme të sporteve dimërore dhe të turizmit në rajon, me perspektivë që të bëhet në të ardhmen një krah i rëndësishëm i zhvillimit ekonomik të Kosovës. (Ruzhdi Pllana)

QENDRA KINEMATOGRAFIKE E KOSOVËS (QKK). Institucioni kryesor në Kosovë që merret me financim dhe ndjek realizimin e projekteve kinematografike. U themelua në vitin 2004, pasi u aprovua Ligji për Kinematografi, ndërsa punën e filloi në vitin 2008. QKK-ja i mori atributet e autoritetit qendror për kinematografi, duke marrë barrën kryesore të financimit të kinematografisë së Kosovës. Mbështet projektet filmike në llojin e filmit artistik të metrazhit të gjatë, filma të metrazhit të shkurtër, dokumentarë dhe të animuar, sipas konkursit publik. Por financon edhe bashkëprodhime dhe projekte për zhvillim skenari. Që nga fillimi, QKK-ja ka mbështetur rreth 79 projekte: 21 filma të metrazhit të gjatë dhe bashkëprodhime, 27 filma të metrazhit të shkurtër, 12 filma dokumentarë, 7 filma të animuar dhe 12 projekte për zhvillim të skenarit. Në QKK janë të regjistruara 129 shtëpi filmike. Është anëtare në European Film Promotion, European Film Academy, Academy of Motion Picture Arts and Sciences-Oscars. QKK-ja ka statutin

e vet të miratuar nga Ministria e Kulturës. Këshilli Drejtues miraton dhe subvencionon projektet filmike në bazë të përzgjedhjes nga juria vlerësuese dhe të raportit të komisionit financiar. (Gani Mehmetaj)

QENDRA KLINIKE STOMATOLOGJIKE UNIVERSITARE E KOSOVËS. Është i vetmi institucion i nivelit tretësor shëndetësor në lëmin e stomatologjisë në vend. Seksioni



QENDRA STOMATOLOGJIKE E KOSOVËS

i stomatologjisë u themelua në kuadër të Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës në vitin 1975. Atë kohë në Kosovë kishte gjithsej 96 mjekë stomatologë, përkatësisht një stomatolog në 15,700 banorë. Deri në vitin 1991 ky institucion funksionoi si organizatë e integruar punuese e quajtur Fakulteti i Mjekësisë me klinikat përbërëse. Në vitin 1991 seksioni i stomatologjisë i Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë u fut nën masa të dhunshme të pushtetit serb dhe, rrjedhimisht, nga puna u largua kuadri mësimdhënës shqiptar. Në këtë kohë shumica e pedagogëve të seksionit të stomatologjisë u detyruan të hapnin klinikat e tyre private, të cilat njëkohësisht u shfrytëzuan edhe për edukimin praktik të studentëve të stomatologjisë. Në qershor të vitit 1999, pas përfundimit të luftës në Kosovë, personeli i seksionit të stomatologjisë u kthye në objektet e mëparshme, në kuadër të Qendrës Klinike Universitare. Në vitin 2003, me udhëzim administrativ të Ministrisë së Shëndetësisë u themelua Qendra Klinike Universitare Stomatologjike e Kosovës. Ajo është e organizuar përmes njësive të pavarura punuese që janë: Klinika e Protetikës Stomatologjike, Klinika e Sëmundjeve të Dhëmbit me Endodonci, Klinika e Parodontologjisë

dhe Mjekësisë Orale, Klinika e Ortopedisë së Nofullave, Klinika e Kirurgjisë Orale, Laboratori i Teknikës së Dhëmbëve, Klinika e Pedodoncisë dhe e Stomatologjisë Preventive, Paraklinika Stomatologjike me Rëntgen Diagnostik, Njësia e Triazhimit me Emergjencë dhe Klinika e Sëmundjeve të Gojës. Misioni i këtij institucioni është përparimi i shërbimeve stomatologjike në vend, duke përfshirë këtu shërbimet shëndetësore, edukimin e kuadrit stomatologjik, zhvillimin e hulumtimeve shkencore, si dhe bashkëpunimin profesional dhe shkencor në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. (Avdyl Krasniqi)

QENDRA KLINIKE UNIVERSITARE E KOSOVËS (QKUK). Qendër mjekësore në Prishtinë, në kuadër të së cilës janë të përfshira të gjitha klinikat spitalore. Ka filluar punën në



QENDRA KLINIKE UNIVERSITARE E KOSOVËS

objektet e Spitalit të Përgjithshëm të Prishtinës, i themeluar më 1958. Me vendimin për themelimin e Fakultetit të Mjekësisë, më 17 qershor 1969 kjo qendër bëhet bazë arsimore e Fakultetit të Mjekësisë. Në vitin 1973 Qendra Spitalore e Prishtinës iu bashkua Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës dhe repartet e spitalit të atëhershëm u shndërruan në klinika dhe institute të Fakultetit të Mjekësisë. Në periudhën 1977-1991 ky institucion funksionoi si organizatë e integruar punuese, e quajtur Fakulteti i Mjekësisë me klinika përbërëse. Më 1991 klinikat e Fakultetit të Mjekësisë u shndërruan në Qendër Klinike Spitalore. Në vitin 1990 Fakultetin e Mjekësisë dhe klinikat e tij pushteti serb i futi nën administrim të dhunshëm. Kjo gjendje vazhdoi deri në qershor të vitit 1999. Gjatë kësaj periudhe shumica e profesionistëve vendorë

shqiptarë u nxorën me dhunë nga puna dhe në vend të tyre u sollën kuadro serbe nga vende të ndryshme të Serbisë dhe nga territoret e banuara me serbë në Kroaci dhe Bosnjë e Hercegovinë.

Pas përfundimit të luftës (1999) dhe vendosjes së Misionit të Përkohshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), Qendra Klinike Spitalore për një periudhë njëvjeçare u administrua nga menaxherë ndërkombëtarë dhe u financua nga Fondi për Zhvillim Ndërkombëtar i Britanisë së Madhe (DFID), si dhe nga donacione të tjera ndërkombëtare. Gjatë këtij viti, profesionistët serbë, të pakënaqur me realitetin e krijuar, pothuajse të gjithë e ndërprejnë punën në Qendrën Klinike Spitalore të Fakultetit të Mjekësisë. Në vitin 2003 kjo qendër u riemërua në Qendra Klinike Universitare e Kosovës, ndërsa në vitin 2013, bazuar në Ligjin për shëndetësi të Kosovës, u formua Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK). Tani Qendra Klinike Universitare e Kosovës, me njësitë e saj, bëhet njësi përbërëse organizative dhe funksionale e Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (SHSKUK). Aktualisht QKUK-ja është institucioni më i lartë shëndetësor, edukativ-arsimor dhe kërkimor-shkencor për lëmenjtë biomjekësorë në vend. Kjo Qendër ofron shërbime shëndetësore të nivelit tretësor spitalor dhe jashtëspitalor (ambulancat specialistike të reparteve) të cilësisë më të lartë të mundshme, brenda resurseve ekzistuese për të gjithë qytetarët e Kosovës dhe shërbime shëndetësore dytësore për rajonin e Prishtinës. Në këtë Qendër, gjithashtu, u zhvillua veprimtaria edukuese për të gjitha drejtimet e Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës dhe të shkollave të mesme publike të mjekësisë. Këtu përfshihet edhe organizimi dhe realizimi i programeve të specializimit, subspecializimit dhe të përsosjes pasuniversitare në lëmenjtë e ndryshëm mjekësorë.

Veprimtaria kërkimore-shkencore në QKUK zhvillohet në përputhje me ligjet në fuqi, në bashkëpunim me institucionet e edukimit shëndetësor, si dhe në bashkëpunim me qendrat vendore dhe ndërkombëtare të specializuara për kërkime shkencore. QKUK-ja është e organizuar në klinika, në shërbime klinike dhe në shërbimin e përbashkët teknik-administrativ. Për t'u themeluar një klinikë e QKUK-së është e domosdoshme që në përbërjen e

saj të jenë të punësuar së paku tre specialistë të licencuar të lëmit përkatës, prej të cilëve së paku dy profesorë dhe dy doktorë ose magjistra të shkencave mjekësore. Veprimtaria shëndetësore, arsimore dhe kërkimore shkencore në QKUK realizohet në 31 klinika të specializuara, 4 shërbime klinike dhe 7 institute të Fakultetit të Mjekësisë. (Avdyl Krasniqi)

QENDRA KOMBËTARE E KOSOVËS PËR TRANSFUZIONIN E GJAKUT. Shërbimi i transfuzionit të gjakut në Kosovë është formuar në vitin 1952, kur në spitalin e vjetër të



QENDRA E TRANSFUZIONI TË GJAKUT

Prishtinës u hap një laborator për përcaktimin e grupit të gjakut dhe për marrjen e gjakut nga dhuruesit familjarë dhe të paguar. Në vitin 1956 është ndaluar marrja e gjakut nga dhuruesit e paguar. Në vitin 1958 shërbimi i transfuzionit të gjakut u vendos në lokalet e reja të spitalit të ri të Prishtinës dhe numri i teknikëve mjekësorë të punësuar në të u trefishua. Në vitin 1972, në shërbimin e transfuzionit të gjakut u punësua mjeku i parë i përhershëm. Ndërkohë, numri i të punësuarve, posaçërisht i mjekëve, shënoi rritje graduale dhe njëkohësisht rritet edhe numri i dhuruesve vullnetarë të gjakut, si dhe vëllimi i punës në terren. Deri në vitin 1989, përveç marrjes së gjakut, në këtë shërbim janë prodhuar edhe tretjet intravenoze, tretjet antikoaguluese për marrjen e gjakut, si dhe sistemet për marrjen dhe dhënien e gjakut. Në këtë kohë ky shërbim u shndërrua në Entin Krahinor për Transfuzionin e Gjakut, ndërsa në vitin 2003 ky institucion u pavarësua nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës dhe u bë njësi e pavarur me emrin Qendra Kombëtare e Kosovës për Transfuzionin e Gjakut me degët e veta në të gjitha spitalet rajonale të

Kosovës, e lidhur drejtpërdrejt me Ministrinë e Shëndetësisë. Qendra Kombëtare e Kosovës për Transfuzionin e Gjakut ka qëllim sigurimin dhe përpunimin e gjakut dhe produkteve të tij për të plotësuar në mënyrën më optimale kërkesat për mjekimin e pacientëve në spitalet e Kosovës. Aktualisht kjo realizohet përmes shërbimit të transfuzionit për pacientët e hospitalizuar përmes shërbimit ambulator të transfuzionit të gjakut dhe të shërbimit për ekzaminimin dhe mjekimin e çrregullimeve të hemostazës. Në këtë Qendër deri tash janë të regjistruar si dhurues gjaku rreth 1% (22,000 dhurues) e qytetarëve të Kosovës, prej të cilëve gjysma janë dhurues vullnetarë dhe gjysma tjetër dhurues familjarë. Në Qendrën Kombëtare të Kosovës për Transfuzionin e Gjakut janë të punësuar 60 veta, specialistë të transfuziologjisë dhe infermierë mjekësorë të aftësuar për këtë lëmi. Synimi afatgjatë i kësaj Qendre është zhvillimi dhe modernizimi i infrastrukturës, zgjerimi i shërbimeve të transfuzionit të gjakut, rritja e numrit të dhuruesve vullnetarë të gjakut, si dhe zhvillimi i hulumtimeve shkencore mjekësore. (Avdyl Krasniqi)

QENDRA LLOGARITËSE ELEKTRONIKE (QLLE) E FAKULTETIT TEKNIK, PRISHTINË. Me qëllim të përparimit të procesit mësimor, në kuadër të seksioneve të veçanta të Fakultetit Teknik të Universitetit të Prishtinës u themeluan disa laboratorë për punë praktike të studentëve në fusha të ndryshme. Kështu, në vitin 1970 u themelua edhe QLLE-ja, në të cilën u instalua kompjuteri i parë IBM 1130, i prodhuesit të njohur botëror IBM. I takonte gjeneratës së dytë të kompjuterëve, prodhimi i të cilëve mbështetej në shfrytëzimin e transistorëve, i cili, krahasuar me kompjuterët e sotëm, kishte karakteristika tejet modeste. Në atë kohë kompjuterë të njëjtë kanë pasur pothuajse të gjitha universitetet europiane dhe amerikane. Me qëllim të avancimit të punës në QLLE në fillim të viteve tetëdhjetë, Fakulteti Teknik u pajis me kompjuterë të gjeneratës së re, IBM 4331. Ky ishte kompjuter i avancuar. Me gjithë fuqinë e tij, ai nuk u shfrytëzua sa duhej, për shkak se me këtë gjeneratë të kompjuterëve hyri në fuqi edhe koncepti i shfrytëzimit të softuerit me pagesë mujore, gjë që Fakulteti Teknik nuk kishte mundësi ta bënte. (Enver Hamiti).

QENDRA PËR INFORMIM E KOSOVËS (QIK). Agjenci e lajmeve, e themeluar më 23 dhjetor 1989 si zyrë për informim e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK). U riemërua në vitin 1991 në Qendra për Informim e Kosovës (QIK), si agjenci e lajmeve. Publikoi lajme në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze, më vonë edhe në gjuhën gjermane dhe frënge. Në fazën e parë, puna e QIK-ut ishte e përqendruar në thyerjen e bllokadës informative që aplikonte Serbia ndaj Kosovës në fillim të viteve '90, më pas kundërvënja propagandës së saj informative dhe përhapja e lajmeve autentike për zhvillimet në Kosovë. Përveç ekipit profesionist në qendër, QIK-u kishte rrjetin e gjerë të bashkëpunëtorëve në të gjitha komunat të vendbanimet e Kosovës, që funksionin si komisione për informim të degëve dhe të nëndegëve të LDK-së, të partive të tjera apo të Këshillit për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut (KMLDNJ). Gjatë viteve '90, QIK-u ishte burim informatash dhe qendër e koordinimit të ekipeve të gazetarëve të huaj që vinin në Kosovë. QIK-u i publikonte i lajmet përmes "Informatorit ditor". Në fillim të viteve '90, për disa vjet, QIK-u publikoi revistën "Ora", e cila përcolli dhe analizoi të gjitha zhvillimet kryesore të asaj periudhe. Ndërkaq, më 1998, deri në fillim të vitit 1999, QIK-u publikoi edhe gazetën e parë të mbrëmjes në Kosovë, "Informatori". Për shkak të rrethanave politike në Kosovë, drejtuesit dhe të punësuarit në QIK u përballën me probleme të shumta, kryesisht për shkak të gjendjes së pushtimit që mbretëronte në ato vite. Kështu, më 1999 u vra udhëheqësi i QIK-ut dhe kryeredaktori i gazetës së mbrëmjes "Informatori", Enver Maloku.

Me qëllim të informimit të opinionit vendor dhe të huaj për çështjen e Kosovës dhe perspektivën e zgjidhjes së saj, QIK-u botoi edhe një sërë librash shkencorë dhe publicistikë, broshura dhe harta, nga fusha të ndryshme, të historisë, demografisë, ekonomisë etj. QIK-u ishte agjencia e parë e lajmeve në Kosovë, e cila filloi shpërndarjen e lajmeve përmes internetit. (Safet Zejnullahu)

QENDRAT DIDAKTIKE. Qendra për trajnimin e mësimdhënësve parauniversitarë, themeluar dhe financuar nga agjenci dhe institucione ndërkombëtare. Në periudhën maj 2001 deri në gusht 2003, në Kosovë u themeluan

pesë qendra të tilla, në Prizren, në Ferizaj, në Pejë, në Gjakovë dhe në Gjiçan, në shërbim të aftësimin profesional të mësimeve në rajonet përkatëse. Fillimisht, veprimtaria e tyre menaxhohej nga Qendra për Arsim e Kosovës, ku u trajnuan me mijëra mësimeve, kryesisht në metodologjinë e mësimeve, menaxhimin e arsimit etj. Nga qershori 2003, qendrat didaktike kaluan nën administrimin e Ministrisë së Arsimit të Shkencës dhe të Teknologjisë të Kosovës. (Halim Hyseni)

QENDRAT E ARSIMIT TË MESËM TË ORIENTUAR (QAMO). Institucione arsimore në shkallë komune të themeluara në vitin shkollor 1977/78. QAMO-t eksperimentale fillojnë të organizohen qysh në vitin 1975 (Ferizaj, Deçan, Leposaviq). Mësimi në këto qendra kishte dy faza: faza e parë ishte ajo e bazave të përbashkëta e arsimit të përgjithshëm për të gjithë nxënësit e klasës së parë dhe të dytë të arsimit të mesëm, ndërsa faza e dytë përfshinte nxënësit e klasës së tretë dhe të katërt, që ishte arsim i orientuar, me drejtimet profesionale të arsimit të mesëm. Në komuna të mëdha (Prishtinë, Gjakovë, Prizren) kishte QAMO për fazën e parë dhe QAMO për fazën e dytë, ndërsa në qendra komunale të vogla kishte nga një QAMO, ku organizohej mësimi si për fazën e parë ashtu edhe për të dytën. Vepruan deri në vitin 1988. (Vlora Sylaj)

QENDRAT KORREKTUESE. Institucione dënimi, riedukimi dhe risocializimi të individëve, delikuentëve, të cilët me sjelljet dhe veprat e tyre cenonin ligjet pozitive të Republikës së Kosovës. Janë institucione në kuadër të Shërbimit Korrektues të Kosovës, i cili u formua në vitin 1999, përkatësisht të Ministrisë së Drejtësisë. Shërbimi Korrektues i Kosovës administron burgjet, përkatësisht qendrat korrektuese në Dubravë, Lipjan, Smrekonicë, si dhe qendrat e paraburgimit në Prizren, Prishtinë, Gjiçan, Pejë dhe Mitrovicë. Për dallim nga qendrat e tjera, Qendra Korrektuese në Lipjan është vetëm për femra dhe të mitur. Përveç regjimit të jetesës, këto institucione ofrojnë edhe aktivitete argëtimi dhe programe arsimimi, trajnimit dhe aftësimi të delikuentëve për mjeshtri e profesione të ndryshme. (Demë Hoti)

QENDRAT KULTURORE SHQIPTARE ISLAME NË EUROPË. Qendra kulturore

shqiptare, në të cilat zhvillohen aktivitete fetare islame, në përputhje me ligjet e vendeve ku veprojnë. Në disa shtete të Europës ekzistojnë qendra të tilla, të cilat veprojnë në kuadër të unioneve ose të bashkësive islame. Në vitin 1986 në Norvegji u themelua Qendra Islamike Kulturore Shqiptare, ndërsa në Danimarkë ekzistojnë qendrat islame shqiptare në kuadër të Bashkësisë Islame Shqiptare në Danimarkë. Në Suedi vepron Bashkimi i Shoqatave Islamike dhe Qendra Islame në Malmo. Në vitin 2006 në Austri u themelua Unioni i Shqiptarëve Myslimanë, ndërsa në Gjermani, një vit më vonë, me pjesëmarrjen e 16 bashkësive islame u themelua Unioni i Qendrave Islame Shqiptare me seli në Shtutgard. Në vitin 2012 u themelua Bashkësia Islame e Zvicrës, nën ombrellën e së cilës veprojnë kryetarët dhe imamët e qendrave kulturore islame shqiptare në këtë vend. Në Itali është aktiv Unioni Shqiptar i Myslimanëve të Italisë, ndërsa në Zagreb vepron Qendra Islamike Shqiptare. (Nuridin Ahmeti)

QENDRAT KULTURORE SHQIPTARE ISLAME NË SHBA. Qendra shqiptare në qytete të ndryshme të SHBA-së, në të cilat zhvillojnë aktivitetet fetar dhe kulturor shqiptarët e besimit islam. Xhamia e parë shqiptare në Amerikë u hap në vitin 1915, në Bideford të shtetit Maine, të cilën e themeloi “Shoqëria fetare myslimane kombëtare e Amerikës”. Një tjetër organizatë e myslimanëve shqiptarë u themelua po në vitin 1915, në qytetin Xhejmstaun (Nju-Jork), kurse fjalorja e tyre u hap në vitin 1951. Në vitin 1954 në Detroit u themelua teqeja e bektashinjve, që funksionoi nën përkujdesjen e Baba Rexhepit (1901-1995). Aktualisht në SHBA, shqiptarët myslimanë janë të organizuar në 13 qendra apo xhami në Konektikat, Filadelfia, Nju-Jork, Nju- Xhersi, Florida, Miçigen dhe Detroit, e cila i kryeson të gjitha. Gjithashtu, veprojnë edhe qendra të tjera, siç janë: Qendra Shqiptare Islamike në Nju-Jork, Shoqata Shqiptare Myslimane e Amerikës në Filadelfia, Qendra Shqiptare Islamike Amerikane në Berkeley, Qendra Shqiptare Islamike në Uiskonsin, Qendra Shqiptare Islamike Amerikane “Hasan Prishtina” në Uoreberi, Qendra Shqiptare Kulturore Islamike në Florida, Qendra Shqiptare Kulturore Islamike në Dallas etj. (Nuridin Ahmeti)

QENDRAT PËR ARSIMIN PROFESIONAL.

Institucione për arsimin e kuadrove profesionale, me kualifikime të ndryshme në një ose disa degë të prodhimit. U themeluan në vitet '60 të shek. XX në kuadër të ndërmarrjeve të mëdha prodhuese. Veprimtaria e tyre lidhej me nevojat e organizatës punuese dhe konsistente në arsimin profesional të punëtorëve, kualifikimin, rikualifikimin dhe aftësimin e tyre për aplikimin e teknologjive të reja të prodhimit. Forma të tilla të arsimit të të rriturve u zhvilluan deri në vitin 1974, kur u realizua reforma e arsimit. Pas saj u themeluan qendrat e arsimit si institucione të arsimit të mesëm profesional, të cilët u mbyllën në vitin 1990. (Demë Hoti)

QENDRAT SOCIALE-EDUKATIVE TË KISHËS KATOLIKE NË KOSOVË. Janë qendra sociale-edukative dhe shkolla, për të cilat përkujdeset Kisha Katolike në Kosovë. Qendrat e këtilla janë hapur kryesisht në periudhën pas lufës së fundit në Kosovë. Kështu, dy qendra sociale-edukative "Don Bosko", njëra në Prishtinë (2003) dhe tjetra në Gjilan (2013), ofrojnë përkujdesje për formimin arsimor dhe aftësimin profesional të të rinjve. "Don Bosko" në Prishtinë përfshin qendrën e formimit profesional, liceun, gjimnazin, shkollën fillore, qendrën rinore, qendrën sportive, bibliotekën, hapësirat për aktivitete sociale e kulturore etj. "Don Bosko" në Gjilan ka dhe sallën e teatrit. Gjimnazi klasik në Prizren "Loyola" u themelua më 2005 dhe, si shkollë partnere e RF të Gjermanisë, është e pajisur me një infrastrukturë moderne. Ndërkaq, Qendra për Arsim dhe Këshillim Profesional "Gjon Nikollë Kazazi" në Gjakovë, e themeluar në vitin 2004, me profilet: ekonomi, teknikë, bujqësi dhe gjimnaz, është e pajisur me kabinete profesionale sipas standardeve bashkëkohore. Mësimi në këto qendra zhvillohet sipas programeve të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe janë të licencuara nga kjo ministri. (Sarë Gjergji)

QENI I SHARRIT. (*Canis Scardus*). Është qen autokton në Kosovë, në Maqedoni dhe në Shqipëri. Në Kosovë këtë racë e quajnë Deltar (Qen delesh). Është racë e krijuar në Gadishullin Ballkanik, e cila njihet që nga parahistoria. Raca dallohet me disa veçori: peshon 38-55 kg me gjatësi 70-82 cm, me qime të gjata (10 cm) dhe me nuanca të ndryshme



QENI I SHARRIT

ngjyrash (ngjyrë hiri, gri, e verdhë me turi të zi, e bardhë etj.). Është i fuqishëm, me kokë të madhe, ndërtim të lidhur, me këmbë të fuqishme muskulore. Ka shikim inteligjent dhe duket shumë i guximshëm. Është tepër agresiv kur paraqitet nevoja. Se është autokton dhe me cilësi të tilla tregojnë dhe të dhënat se ushtria e Lekës së Madh përdorte qentë e kësaj race për t'i luftuar luanët, tigrat dhe elefantët në zonat aziatike të luftës. Nga Aristoteli u përshkrua si ruajtës i kopeve dhe i veçantë për nga përmasat, ndërsa kronisti romak, Varroni, e përshkroi me "pamje luani". Gjendej në një pjesë të madhe të Ballkanit, por raca e pastër u ruajt në malet e Sharrit. Si Deltari Ilir u regjistrua në vitin 1939 në Federatën Kinologjike Ndërkombëtare (nr. 41), si racë e veçantë dhe më e përafërt me trungun gjenealogjik të qenit ilir të molosëve, ndërsa në vitin 1957 iu ndryshua emri në "Qeni i maleve të Sharrit", me kërkesën e ish-Federatës Jugosllave. U përdor si qen ushtrie në ushtrinë e Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene nga viti 1928, ndërsa nga viti 1943 edhe në ushtrinë jugosllave. Federata Kinologjike e Kosovës përkujdeset për ruajtjen dhe mospërzjerjen e racës së standardizuar si Deltar Ilir nga viti 1990. (Behxhet Mustafa)

QERIMI Bajram (1953-1978). Poet dhe prozator. Lindi në fshatin Tërpezë të Vitisë. Kreu shkollën fillore në vendlindje dhe në Pozharan, të mesmen në Ferizaj dhe Viti. Absolvoi në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Nuk arriti të diplomojë, sepse më 19 korrik 1978 u vra për motive politike. Që nga bankat e shkollës u mor me shkrime letrare dhe u shqua për talentin e tij. Deri atëherë kishte botuar disa prej shkrimeve në shtypin e kohës, por shumë nga shkrimet e tij kishin mbetur

në dorëshkrim. Ato u botuan në vitin 1993 nga Shtëpia Botuese "Buzuku": "Sarkofagu i këngës" (poezi), "Erosi prej argjile" (poezi), "Shija e verës" (tregime) dhe "Kordelja e artë" (tregime për fëmijë). (Nazmi Rrahmani)

QERIMI Bujar (1958-). Trajner, hendbollist. Lindi në Ferizaj. Sportist i dalluar i skuadrës së njohur "Borci", pivotmen i pandalshëm nga vija e 6-metërshit. Para se të fillonte me hendboll, luajti edhe basketboll. Një kohë të gjatë ishte pjesë e kësaj skuadre dhe mori pjesë në të gjitha sukseset e "Borcit" deri më 1989, kur u largua nga Kosova dhe shkoi në "Umag" të Kroacisë. Në vitin 1990 kaloi në radhët e "Herstaldit" të Belgjikës, ku edhe e vazhdoi karrierën e tij si lojtar deri në vitin 1996. Më pas vazhdoi karrierën si trajner. Prej vitit 2009-2013 ka qenë trajner i përfaqësueses së Belgjikës për të rinj. (Edmondn Thaçi)

QERIMI Haqif (1943-2010). Biolog, profesor universiteti. Lindi në Koshare të Ferizajt. Shkollimin bazë e mori në vendlindje dhe në Prishtinë, ndërsa studimet për biologji i kreu në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës (1968). Studimet pasuniversitare i përfundoi në Universitetin e Zagrebit, drejtimi biologji molekulare dhe tezën e disertacionit të doktoratës e mbrojti në Institutin "Rugjer Boshković" në Zagreb (1981). Në vitin 1971 zgjidhet asistent në seksionin e biologjisë në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore të Universitetit të Prishtinës, ku vazhdoi punën për shumë vjet, duke u avancuar në të gjithë titujt universitarë. Publikoi punime shkencore dhe kumtesa në tubime shkencore. Është autor i teksteve shkollore dhe universitare ("Biokimia" etj.). Kreu detyra organizative në institucionet e shkollimit të lartë. (Fetah Halili)

QERIMI Sami (1929-). Veprimtar për emancipim e popullsisë shqiptare të Kosovës Lindore. Lindi në Preshevë, ku kreu shkollën fillore, ndërsa gjimnazin e kreu në Prishtinë (1950). Më pas kreu agronominë në Universitetin e Beogradit. Në periudhën 1956-1959 punoi në Kooperativën Bujqësore të Preshevës, ndërsa në periudhën 1960-1982 ishte drejtor i Stacionit të Duhanit në Preshevë. U angazhua për hapjen e një shkolle të mesme në Preshevë, synim i cili u realizua më 1962, kur u hap paralelja e gjimnazit "Bora Stanković" të Vrajës

dhe që më 1968 u emërtua "Skënderbeu". Në vitet 1982-1985 ushtroi detyrën e kryetarit të Kuvendit Komunal të Preshevës. Kontribuoi në plotësimin e administratës dhe infrastrukturës komunale në Preshevë e rrethinë, sidomos në elektrifikimin e fshatrave të Karadakut dhe ndërtimin e rrugës Preshevë-Gjilan (1979/1980). Më 1985 u zgjodh delegat në Kuvendin Federativ të Jugosllavisë për zonën e Preshevës. Është marrë edhe me publicistikë dhe nga kjo fushë ka botuar librin "Koha e ngritjes, e krenarisë dhe e dhimbjes" (2011). (Fehmi Rexhepi).

QERIMI Vebi (1955-). Aktor, regjisor, mësimdhënës. Lindi në Kumanovë, ku kreu shkollimin fillor dhe të mesëm. Studimet për Aktrim i kreu në Fakultetin e Artit Dramatik në Shkup (1979). Luajti në një sërë rolesh, kryesisht në shfaqje të Teatrit të Kombësive (Drama Shqipe), përkatësisht në Teatrin Shqiptar të Shkupit, nga të cilat veçohen: "Henriku IV", "Hamleti", "Shi në Uertemonto", "Mbreti Lir", "Gof", "Shkolla e grave", "Babai", "Tregimi zoologjik", "Zeka i zi udhëton për në Babilon", "Kush e solli Doruntinën", "Vdekja dhe virgjëresha", "Syshkruari", "Stjuardesat", "Fani vjen vetëm", "Vojcek", "Kaligula" etj. Përveç në teatër, luajti edhe në disa filma të metrazhit të gjatë ("Dust", "Koha e kometës" etj) dhe në seriale televizive ("Mëhalla jonë", "Evleda Rumeli" etj.). Bëri edhe regjinë e disa shfaqjeve, si: "Njeriu që pa vdekjen me sy", "Policët", "Volpone", "Tetua e Karlit", "Rrënjët e kullës" etj. Në periudhën 1995-1999 punoi si asistent i aktrimit, me mësim në gjuhën shqipe, në Fakultetin e Artit Dramatik në Shkup dhe më pas në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Tetovës. Nga viti 1980 është aktor në Teatrin Shqiptar të Shkupit. Kushtrim Bekteshi)

QERIQI Ahmet (1946-). Gazetar. Lindi në fshatin Krojmir, komuna e Lipjanit. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Prishtinë, ku më pas mbaroi studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës (1973), si dhe studimet pasuniversitare. Ka punuar në gjimnazin e Ferizajt, në Akademinë Pedagogjike dhe në Shkollën e Mesme Teknike në Prishtinë. Ishte pjesëmarrës i lëvizjes ilegale dhe disa herë ka qenë i dënuar për veprimtari politike. Ka marrë pjesë në luftën e UÇK-së dhe ishte njëri ndër themeluesit

dhe drejtuesit e Radios "Kosova e Lirë". Në periudhën e pasluftës ishte drejtor i kësaj radioje. Ka botuar një sërë veprash letrare dhe publicistike, si romanet: "Meditime në arrati" (2000), "Burgu" (2004), "Koha e jeniçerëve" (2009) etj., si dhe veprat studimore dhe monografite: "Fenomene shqiptare" (2005), "Gjurmime dhe studime" (2011), "Luftëtarë të NDSH" I, II etj. (Nehat Islami)

QERSHIA DHE VISHNJA. Qershia (*Prunus avium* L.) bën pjesë në familjen trëndafilore (*Rosaceae*). Është kulturë gjettherënëse. Rajonet me sipërfaqe më të mëdha me vishnje janë Gjakova, Klina dhe Gjilani. Kultivarët më të njohur dhe më të përhapur janë: Burlat, Van, Stela, Delbastia e Prizrenit, ndërsa nënshartesat gjenerative janë: qershia e egër, mëzhdrava, vishnja e rëndomtë, vishnja e stepës, nënshartesat vegetative: F12/1, Kolt, F4/13, mëzhdrava St 64, Vedensfill 101, këmbëzat e vishnjës, Stokton Morello, Prunet, Gisela 5, 6. Vishnja (*Prunus cerasus* L.) është e ngjashme me qershinë për nga shumë veçori. Plantacionet me vishnje në Kosovë kanë filluar të ngriten intensivisht që nga viti 1970. Kosova ka kushte të mira agroekologjike, fuqi punëtore, kapacitete për ngrirje, ndërsa kërkesat për eksport janë në rritje. Kultivarët më të njohur dhe më të përhapur te ne janë: reksele, konserva e Hajmanit, vishnja kamëzore, rubini i Hajmanit, kelleriis 14, kelleriis 16, nënshartesat gjenerative më të përhapura janë qershia e egër mëzhdrava, vishnja e rëndomtë, nënshartesat vegetative: F12/1, Kolt, F4/13, mëzhdrava St 64, vedensfill 101, kabëzat e vishnjës, gisela 5, 6. (Agim Zajmi)

QERRETI Dervish (1950-). Inxhinier i arkitekturës, profesor universiteti. Lindi në Kryshec të Pejës, shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërkaq shkollën e mesme të artit në



DERVISH QERRETI

Pejë. Studimet për arkitekturë i kreu në Fakultetin e Arkitekturës të Universitetit të Sarajevës (1979) dhe po aty i përfundoi studimet pasuniversitare dhe mbrojti disertacionin (2012). Në fillim u angazhua si arkitekt i pavarur në byronë projektuese "Unikos Projekt" (1980). Në vitin 1981 u zgjodh asistent dhe më pas ligjërues dhe

profesor asistent në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe të Arkitekturës të Universitetit të Prishtinës. Veprimtarinë profesionale e filloi në Sarajevë dhe më vonë në Kosovë (rrobaqepësia e Shërbimit Edukativo-Korrektues në Lipjan, në qendrën tregtare në Obiliq, në qendrën zejtare-tregtare në Malishevë). Janë për t'u veçuar projektet për përmendoren e dëshmorëve të luftës në Pestovë të Vushtrrisë (2000), kompleksi memorial i "Shtjefën Gjeçovit" në Zym të Hasit (2003) si dhe përmendorja në sheshin "Mujë Krasniqi" në Klinë (2004). Vazhdon aktivitetin profesional në projekte të ndryshme në Prishtinë dhe në qytetet e tjera të Kosovës. (Flamur Doli).

QEVERIA E KOSOVËS (BANKA E BASHKUAR), PRISHTINË (Arkitektura). Për nevojat e Bankës së Bashkuar të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, në qendër të



SELIA E QEVERISË SË KOSOVËS (ISH-BANKA E BASHKUAR)

Prishtinës u ndërtua godina me lartësi prej 55 m, e cila u shfrytëzua për këtë qëllim deri në vitin 1999. Projekti i ndërtesës së Bankës së Bashkuar të Kosovës u punua në vitin 1970 nga byroja projektuese "Invest Byro" me ark. M. Radulović nga Beogradi. Ndërtimi i objektit përfundoi në vitin 1976 në qendër të Prishtinës, me arkitekturë moderne dhe me përdorim të materialeve bashkëkohore për kohën. Objekti cilësohej si një ndër kullat më të larta dhe më të njohura të kohës në ish-Jugosllavi. Trajtimi

dhe përdorimi i fasadës së varur strukturale e bënte ndërtesën të shquhej me bukurinë e saj jo vetëm në Prishtinë, por edhe më gjerë. Gjatë bombardimeve të NATO-s në vitin 1999, ndërtesa u dëmtua rëndë, prandaj në vitin 2003 u bë projekti i renovimit nga byroja projektuese boshnjake “Union Invest” nga Sarajeva, ndërsa në vitin 2004 fillon realizimi i punëve ndërtimore nga ndërmarrja ndërtimore “Nartel” nga Prishtina. Ndërtesa ka sipërfaqe rreth 16,000 m² me dimensione rreth 50 m x 19 m gjerësi, me etazhitet 2B+P+15, me hapësirë për punë të 600 punëtorëve. Etazhet 1-14 janë paraparë për zyra të punëtorëve, kurse në katin e 15-të është etazhi teknik, në të cilin janë të vendosura pajisjet për klimatizim. Punët e rinovimit të ndërtesës përfunduan në vitin 2005, kurse në vitin 2006 në hapësirat e kësaj ndërtese u vendos Qeveria e Republikës së Kosovës. (Vlora Navakazi)

QEVERIA E KOSOVËS (PALLATI I SHTYPIT), PRISHTINË (Arkitektura). Në vitin 1971, nga arkitekti maqedonas G. Konstantinovski u punua projekti për ndërtimin e



MINISTRITË E QEVERISË SË KOSOVËS (ISH-PALLATI I SHTYPIT)

objektit për të gjitha mediet në Kosovë, me arkitekturë të cilësuar të stilin brutalist të ndërtimit, që ishte karakteristikë e lëvizjes arkitektonore prej viteve ‘50 deri në vitet ‘70 të shekullit të kaluar. Ndërtimi i objektit filloi në vitin 1972 dhe zgjati deri më 1978 nga ndërmarrja “Koso-

va” e Vushtrrisë. Objekti ka 18 kate, me sipërfaqe prej 50 mijë metrash katrorë dhe lartësi 72 m². Objekti është i përbërë nga dy pjesë: nga pjesa e parë “aneksi” me etazhitet B+P+2. Në përdhese të aneksit ishin të vendosura shtypshkronja “Rilindja” dhe dyqanet, kurse në 2 etazhet e sipërme ishte i vendosur shërbimi i shpërndarjes së gazetave dhe i tregtisë. Pjesa e dytë e objektit është kulla (B+P+17), e cila është e lidhur me objektin e parë përmes një korridorri që shërbente vetëm për punëtorë. Në nëntë katet e para të kullës ishin të vendosur shërbimet e përbashkëta të NGBG “Rilindja”, redaksia e gazetës “Rilindja”, redaksitë e revistave dhe redaksia e botimeve “Rilindja”. Në katër katet vijuese ishte e vendosur NGB “Jedinstvo”, ndërsa në katin e 15-të redaksia e gazetës “Tan” dhe shtëpia botuese me të njëjtin emër. Kati i 15-të ishte lënë i zbrazët dhe, së bashku me amfiteatrin dhe disa objekte përcjellëse në aneksin e poshtëm, nuk u bë funksional deri në renovimin e objektit. Pas vitit 1991 dhe shkatërrimit të vazhdueshëm të njësive të NGBG “Rilindja”, Pallati i Shtypit u uzurpua pjesë-pjesë, ndërsa shtypshkronja u plaçkit dhe u bë jofunksionale. Pas vitit 1999, NGBG “Rilindja” nuk arriti t’i vinte në veprim, as aktivitetet prodhuese, as ato botuese dhe informative. Si objekt i ish-ndërmarrjes shoqërore, Pallati i Shtypit u vendos nën përkujdesje të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit. Në vitin 2004 u përgatit projekti i rehabilitimit të ndërtesës, i cili përfundoi në vitin 2009. Rehabilitimi u krye nga Grupi “Mabetex” për nevojat e Qeverisë së Republikës së Kosovës, me një sipërfaqe shfrytëzuese prej 20,000 m², për akomodim të 850 punëtorëve të katër ministrive. Aneksi i ish-shtypshkronjës u dha me qira për destinacione të ndryshme. (Vlora Navakazi)

QEVERIA E PËRKOHSHME E LIDHJES SHQIPTARE TË PRIZRENIT.

Komiteti Kombëtar i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, i cili në janar të vitit 1881 mori atributet e një qeverie të përkohshme. Udhëheqësit e këtij komitetit ishin: Imer Prizreni, Abdyl Frashëri, Sylejman Vokshi, Shaip Spahiu, Ali Ibra etj. Komiteti mori vendim për përgatitjen e kryengritjes së përgjithshme dhe formimin e qeverisë së përkohshme. Në mbledhjen e janarit të vitit 1881, Komiteti Kombëtar u shpall qeveri e përkohshme me kryetar Ymer Prizrenin. Veprimtaria e qeverisë së përkohshme u

shtri në shumë pjesë të vilajetit të Kosovës dhe vilajeteve të tjera. Veprimtaria e saj u përqendrua në ngritjen e forcave të armatosura shqiptare, në vendosjen e rendit publik, në organizimin e administratës së re e sidomos të gjykatat shqiptare, në krijimin e një buxheti të shtetit shqiptar nëpërmjet përqendrimit në duart e lidhjes të taksave shtetërore. Nga administrata e re, që u ngrit në viset e çliruara, u larguan jo vetëm funksionarët turq, por edhe sulltanistët shqiptarë. Këto veprime të qeverisë së përkohshme krijuan shqetësime si te Porta e Lartë, ashtu edhe te Fuqitë e Mëdha, sepse me këto veprime, sipas tyre, në Ballkan po prishej statuskuoja. Po ashtu shqetësime shprehën edhe shtetet ballkanike, si Greqia, Serbia dhe Mali i Zi. Në këto rrethana, Perandoria Osmane ndërmoi masa ushtarake të komanduara nga gjenerali Dervish Pasha. Qeveria e përkohshme mori masa për t'u mbrojtur nga Porta e Lartë. Pas marrjes së Shkupit, ushtria osmane iu drejtua Grykës së Kaçanikut dhe më pas, më 7 prill, mori Ferizajn dhe u nis në drejtim të Shtimes dhe Grykës së Carralevës, ku u zhvilluan luftime të përgjakshme. Ushtria e Qeverisë së Përkohshme e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit nuk arriti t'i përballonte sulmet e ushtrisë osmane. Luftimet e përgjakshme u zhvilluan më 21 prill në Slivovë, ku të dyja palët pësuan humbje të mëdha. Pas këtyre luftimeve ushtria osmane vazhdoi operacionet në Grykën e Carralevës, në fshatin Dule dhe në hyrje të Suharekës. Të nesërmen, më 21 prill 1881, Dervish Pasha me shtatë gjeneralë të tjerë osmanë që komandonin 24 batalione hyri në Prizren, ku shpalli menjëherë shtetrrëthimin dhe bëri arrestime të shumta. Me këtë mori fund qeveria e përkohshme e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. (Isa Bicaj)

QEVERIA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS.

Përfaqëson pushtetin ekzekutiv në Republikën e Kosovës, institucion që propozon dhe zbaton ligjet e vendit. Me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Qeverinë e Kosovës e përbëjnë kryeministri, zëvendëskryeministrat dhe ministrat. Qeveria e Kosovës ushtron pushtetin ekzekutiv në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin. Sipas Kushtetutës, Qeveria, ndër të tjera, ka këto kompetenca: propozon dhe zbaton politikën e brendshme dhe të jashtme të vendit, mundëson zhvillimin ekonomik të vendit, i propozon Kuvendit projektligje dhe akte të

tjera, merr vendime dhe nxjerr akte juridike ose rregullore, propozon buxhetin e Republikës së Kosovës, mbikëqyr punën e organeve të administratës, i propozon presidentit të Republikës së Kosovës emërimet dhe shkarkimet e shefave të misioneve diplomatike, propozon amendamentimin e Kushtetutës etj. Kryeministri, ndërkaq, përfaqëson dhe udhëheq Qeverinë, siguron që të gjitha ministratë të veprojnë në pajtim me politikat qeveritare, siguron zbatimin e ligjeve dhe të politikave të përcaktuara të Qeverisë, ndërron anëtarët e Qeverisë, pa pëlqimin e Kuvendit, kryeson Këshillin e Sigurisë të Kosovës, emëron drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Kosovës, së bashku me presidentin emëron drejtorin, zëvendësdrejtorin dhe inspektorin e përgjithshëm të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, këshillohet me presidentin për zbatimin e politikës së jashtme të vendit etj. Procedura për zgjedhjen e mandatarit dhe të Qeverisë gjithashtu është e përcaktuar me Kushtetutë. Pas zgjedhjeve, presidenti i Republikës i propozon Kuvendit kandidatin për kryeministër, në konsultim me partinë politike ose koalicionin që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend, për të formuar Qeverinë. Qeveria konsiderohet e zgjedhur nëse merr shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Anëtarët e Qeverisë, pas zgjedhjes, japin betimin para Kuvendit. Numri i anëtarëve të Qeverisë përcaktohet me aktin e brendshëm të saj, ku së paku një ministër duhet të jetë nga komuniteti serb dhe një ministër nga ndonjë komunitet tjetër joshumicë në Kosovë. Po ashtu, duhet të jenë së paku dy zëvendësministra nga komuniteti serb i Kosovës dhe dy zëvendësministra nga komunitetet e tjera joshumicë në Kosovë. Kryeministri, zëvendëskryeministrat dhe ministrat e Qeverisë mund të zgjidhen nga deputetë të Kuvendit të Kosovës ose nga persona të kualifikuar, që nuk janë deputetë të Kuvendit. Sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Qeveria për punën e saj i përgjigjet Kuvendit të Kosovës. Kryeministri, zëvendëskryeministrat dhe ministrat mbajnë bashkëpërgjegjësinë për vendimet që merr Qeveria dhe përgjegjësinë individuale për vendimet që marrin në fushat e kompetencave të tyre. Qeveritë e Kosovës, pas shpalljes së pavarësisë, kishin numër të ndryshëm të ministrave. (Blerim Reka)

QEVERTË E KOSOVËS (1974-2008). Deri me shpalljen e Pavarësisë më 17 shkurt 2008, Kosova kishte status të ndryshëm politik dhe lloje të ndryshme të qeverisjes dhe të qeverive. Sprova e parë për një qeveri autonome ishte Qeveria tremujore e Hasan Prishtinës në Kosovën e çliruar nga Perandoria Otomane (12 gusht-14 tetor 1912), ndërsa midis dy luftërave botërore një lloj qeverie në mërgim ishte Komiteti Mbrojtja e Kosovës. Pas Luftës së Dytë Botërore, pas qeverisjes ushtarake (1945-1946), Kosova pati 3 lloje të ndryshme të qeverive me po aq emërtime të ndryshme.

Qeveria e parë e Kosovës ishte ajo që njihej si Këshilli Krahinor, që erdh pas përfundimit të administrimit ushtarak. Nga viti 1946-1953, Kosova kishte Statutin, si aktin më të lartë juridik dhe nuk pati Këshill Ekzekutiv, por vetëm një këshill pa kompetenca ekzekutive dhe qeverisëse. Kushtetuta e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (RFPJ) e vitit 1946 e përcaktonte Kosovën si krahinë autonome, pozita e së cilës rregullohej me Statutin e saj (1948), i cili rregullonte organizimin e Krahinës, fushëveprimin e organeve krahinore dhe organizimin e pushtetit lokal. Me Ligjin Kushtetues të RFPJ-së (1953) dhe Statutin e dytë të Kosovës (1953), pozita e Kosovës rregullohej me Ligjin Kushtetues të RP të Serbisë (1953), duke i humbur edhe ato pak autorizime qeverisëse, të cilat i barteshin Serbisë. Pas nxjerrjes së Kushtetutës së RSFJ-së (1963), Kosova nxori Statutin e saj të tretë, i cili nuk solli qeverisje ekzekutive të organeve të Kosovës, pra as Qeveri të Kosovës. Vetëm pas Kushtetutës së RSFJ-së të vitit 1974 dhe nxjerrjes së Kushtetutës së KSA të Kosovës të po atij viti, Kosova bëhet me Këshillin Ekzekutiv (KE), i cili funksionoi më së gjati, plot 15 vjet (1974-1989), deri në suprimimin e autonomisë së Kosovës nga Serbia. Duke qenë organ ekzekutiv i formuar mbi bazën e sistemit të delegimit komunist dhe jo si rezultat i zgjedhjeve të lira parlamentare, ajo qeveri ishte më tepër një trup ekzekutiv i partisë në pushtet. Kryetarë të KE-së ishin nga Ymer Pula, Ilija Vakiqi, Bahri Oruçi, Riza Sapunxhiu, e deri te i fundit, Jusuf Zejnullahu.

Qeveria e dytë ka qenë Qeveria në mërgim e Kosovës, që funksionoi nëntë vjet (1990-1999), në periudhën e pushtimit serb, me kryeministër Bujar Bukoshin. Kjo qeveri nuk ishte e njohur ndërkombëtarisht dhe vetëm

pjesërisht e pranuar nga Shqipëria. E treta ka qenë Qeveria e Vetëqeverisjes së Përkohshme, e cila, mbështetur në Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, ishte zgjedhur pas zgjedhjeve të para nën UNMIK-un (2001 dhe 2004), me kryeministrit: Bajram Rexhepi, Ramush Haradinaj, Bajram Kosumi dhe Agim Çeku. Këto qeveri të përkohshme funksionuan 7 vjet, deri në shpalljen e pavarësisë së Kosovës. Përfundimisht, vetëm me shpalljen e pavarësisë dhe fuqizimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, pas zgjedhjeve të para parlamentare të Kosovës si shtet u zgjodh Qeveria e Republikës së Kosovës, në dy mandate (2011 dhe 2014), duke u njohur ndërkombëtarisht nga 108 shtete anëtare të OKB-së. Kryeministrit të dy qeverive të Republikës së Kosovës ishin Hashim Thaçi dhe Isa Mustafa. (Blerim Reka)

QËNDISJET TRADICIONALE. Lloj i artit popullor që merret me zbulimin e pëlhurave, duke përdorur gjilpërën dhe penj shumëgjyrësh si mjete të punës. Tradita e



qëndisjes është e lashtë, ndërkaq objektet më të spikatura që kanë mbijetuar deri më sot janë punuar në shekujt XIX dhe XX. Qëndisjet realizoheshin në pëlhura të mëndafshta, të pambukta dhe të leshta. Ato janë punuar në kuadër të artizanaleve shtëpiake ose nga zejtarët qëndistarë. Objektet qëndiseshin me fije ari, mëndafshi, pambuku dhe me rruaza. Qëndiseshin me gjilpërë në gjergjef, me teknikën e mbushjes, me kryqe, gjysmëkryqe, “toledo” dhe azhur. Qëndisjet kishin motive gjeometrike në formë të rrumbullakët, në formë trekëndëshi, katrori, katërkëndëshi dhe rombi të imët në formë rrjete. Ndër motivet zoomorfë pëlqeshin zogjtë, gjarpërinjtë e pallonjtë

në pamje natyrore ose të stilizuar. Pëlhurat e qëndisura ishin këmishët, përparëset, shamitë e kokës, rizat e dorës, tekstilet e interierit, ato të sofrës dhe të dhomës së fjetjes. Janë të njohura qëndisjet e xhybeve, të dollomave dhe tekstileve në Prizren, Pejë dhe Gjakovë. Gjithashtu njihen edhe këmishët dhe mbulesat e kokës të rajoneve të Hasit të Prizrenit, të Rrafshit të Dukagjinit dhe të Rugovës. Ndërkaq, këmishët dhe mbulesat e kokës të qëndisura me rruaza karakterizojnë veshjet kombëtare të nuseve dhe të grave të reja të Drenicës. Sot pjesa dërrmuese e qëndisjeve ruhen nëpër shtëpi private dhe disa sosh në muzetë etnografikë të Kosovës. Disa syresh përdoren edhe sot në raste të shënuara gazmendi dhe pikëllimi. (Shpresa Siqeca)

QIREZI. Fshat në Drenicë, rreth 13 km në juglindje të Skënderajt. Është vendbanim i tipit të shpërndarë, me sipërfaqe rreth 682 ha, lartësia mbidetare 710 m. Ka lidhje të mira rrugore me vendbanimet përreth dhe qendrat e tjera. Rrugë të asfaltuara e lidhin me Skënderajin dhe me magjistralen Skënderaj-Vushtrri. Me emrin Çirez dhe Çirtesh përmendet në regjistrat osmanë të viteve 1455, 1477 dhe 1487. Në vitin 1948 kishte 448 banorë, ndërsa në vitin 2011 u regjistruan 1,015 banorë. Veprimtaritë kryesore ekonomike të popullsisë janë bujqësia dhe blegtoria. Kultivohen drithërat, pemët, perimet etj. Ka shkollë 9-vjeçare, qendrën e mjekësisë familjare, disa njësi tregtare e zejtare, si dhe një gurore aktive. Është bashkësi lokale, ku gravitojnë vendbanimet: Baks, Krasaliq, Krasmiroc, Kozhicë dhe Prelloc. Me planin zhvillimor komunal të vitit 2010 ka fituar statusin e nënqendrës urbane. (Ramiz Cërvadiku)

QIREZI Ahmet (1930-). Dramaturg, aktor. Lindi në Qirez të komunës së Skënderajt. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Vushtrri, më pas Shkollën e Lartë Pedagogjike për gjuhë dhe letërsi shqipe (1969). Një kohë punoi si mësues. Punën e aktorit e filloi në Teatrin Popullor Krahinor (TPK) në vitin 1954, ku punoi deri në vitin 1970. Pastaj deri në vitin 1990, punoi si gazetar-redaktor



AHMET QIREZI

në redaksinë e kulturës të Radiotelevizionit të Prishtinës. Në skenën e TPK-së luajti një sërë rolesh në dramën shqipe dhe atë serbe, përfshirë edhe rolet kryesore në shfaqjet "Zonja me kamelië", "Ditari i Ana Frankut", "Nita" etj. Më 1958 shkroi dramën "Vrasja e errët", që u shfaq në Teatrin Amator të Ferizajt, pastaj "Çipçijtë", që u botua më 1960 dhe më pas u shfaq në Teatrin Amator në Mitrovicë. Më 1966 shkroi dramën "Erveheja", sipas motiveve të poemës së poetit bejtexhi Muhamet Kyçyikut, në të cilën trajtohet fati i gruas në një shoqëri me mentalitet konservator. Drama u shfaq premierë në Teatrin Popullor Krahinor më 1966, në regji të Muharrem Qenës, mori shumë çmime në festivalet më prestigjioze të Serbisë dhe të ish-Jugosllavisë ("Joakim Vujiq", 1967; "Sterijino pozorje", 1968). Ishte shfaqja që qëndroi më gjatë dhe që kishte më së shumti prizra në TPK. "Erveheja" është vënë në skenë edhe në Teatrin e Prizrenit më 1985. Në vitin 1967 A. Qirezi shkroi dramën historike "Skënderbeu", e cila u shfaq në Teatrin e Prizrenit në vitin 1968, në 500-vjetorin e vdekjes së Skënderbeut, ndërsa një vit më vonë dramën "Ngjyrat e jetës", e cila mori çmimin e parë në konkursin e dramës të TKK-së. Në periudhën 1970-1981 shkroi analiza dhe kritika për shfaqjet teatrore në Kosovë, të cilat transmetoheshin në valët e Radio-Prishtinës. Pas vitit 1981, për shkaqe politike, u largua nga jeta kulturore. (Besim Rexhaj)

QIRIAZI Gjerasim (1858-1894). Rilindës, veprimtar i arsimimit të femrës shqiptare, pedagog, Mësues i Popullit. Lindi në Tërnovë, afër Manastirit, ku vijoi shkollën fillore në gjuhën greke. Në vitin 1877 u pranua në Shoqërinë Ungjillore të Manastirit. Një vit më vonë filloi studimet biblike në Kolegjin Teologjik Amerikan në Samokovë, Bullgari, të cilat i përfundoi në vitin 1882, kur emërohet pastor praktikant në një kishë protestante në Bullgari. Një vit më pas emërohet ungjilltar i shqiptarëve dhe fillon punën në Shoqërinë Biblike Britanike në Manastir, si dhe bëri udhëtimin e parë nëpër Shqipëri. Shkoi në Stamboll dhe kontaktoi me K. Kristoforidhin. Ishte përkthyes dhe



GJERASIM QIRIAZI

mbikëqyrës i botimit në shqip të Shkrimeve të Shenjta në Manastir dhe shpërndarës i librave të Shoqërisë Biblike në Maqedoni dhe në Shqipëri. Më 11 maj 1890 u mbajt edhe shërbesa e parë publike protestante në Korçë. Me ndihmën e Naim Frashërit dhe në mbështetje të diplomës së motrës së tij, Sevastisë, Gj. Qiriazi arriti që nga autoritetet osmane në Stamboll, në vitin 1891, të marrë leje për hapjen e një shkollë për vajza në Korçë. Shkolla u themelua dhe zhvilloi veprimtarinë e saj sipas projektit dhe planit mësimor të hartuar nga Gj. Qiriazi. Ishte shkolla e parë kombëtare shqipe për vajza. Në vitin 1892, ai themeloi Kishën Ungjillore të Korçës dhe shoqërinë “Vëllazëria Ungjillore e Shqipërisë” me seli në Korçë. Njëkohësisht botoi edhe numrin e parë të gazetës së shoqërisë “Letra e Vëllazërisë”. Ishte ndër të parët që u mor me përhapjen e veprave letrare, abetareve dhe të shtypit shqiptar në trevat shqiptare. Për nevojat e Mësonjëtores së Vajzave në Korçë, Gj. Qiriazi shkroi dhe përktheu poezi në gjuhën shqipe, shkroi dhe kompozoi këngë, shkroi dialogë, përralla etj. Shumë prej krijimeve të tij u botuan në veprën “Këngë të shenjtëraura për faltoret shqipe” (1924). Shkroi edhe veprën “Pengu i kaçakëve”. Shumicën e krijimeve të tij i mblodhi vëllai i tij, Gjergji, dhe i botoi me titull “Hristomathi a udhëheqës për çdo shtëpi shqiptari” (vëllimin e parë më 1902, vëllimin e dytë më 1907). Gj. Qiriazi u mor edhe me çështje teorike pedagogjike. Ishte iluminist, çmonte diturinë dhe arsimin kombëtar. Angazhohej për edukatën fizike, intelektuale, morale, të punës dhe edukatën fetare. Shkollën e cilësoi si “vend i shenjtëruar” në shërbim të emancipimit të kombit dhe të zhvillimit të atdheut. (Xhafer Ismajli)

QIRIAZI Parashqevi (1880-1970). Njëra nga mësueset e para shqiptare të arsimit të femrave, pedagoge, aktiviste, Mësuese e Popullit. Lindi në Manastir, ku kreu edhe shkollën fillore dhe të mesmen qytetëse. Studioi në Kolegjin Femëror Amerikan në Stamboll. Pas përfundimit të studimeve më 1904, filloi punën e mësueses dhe drejtueses në Shkollën e Vajzave në Korçë. Ishte femra e vetme që mori pjesë në Kongresin e



PARASHQEVI
QIRIAZI

Manastirit (1908). Ishte njëra nga themelueset e shoqërisë së parë të grave shqiptare “Yll’i mëngjezit” në Korçë (1909). Atë vit botoi edhe abetaren e parë me alfabetin e Manastirit me titull “Abetare për shkollat e para”. Në vitin 1910 shkroi edhe himnin e alfabetit kombëtar të shqipes. Në vitin 1912 u regjistrua në Fakultetin Pedagogjik të Universitetit të Oberlin (SHBA). Atje hartoi edhe planin arsimor për Qeverinë e Ismail Qemalit. Më 1915 mori pjesë në formimin e Partisë Politike-Partia Kombëtare Shqiptare dhe redakttoi revistën “Yll’i mëngjezit” në Boston. Mori pjesë në Konferencën e Paqes në Paris (1919). Në vitin 1922 u kthye në Shqipëri dhe bashkë me motrën e saj, Sevastinë, hapën Institutin Arsimor “Kyrias” në Kamëz (Tiranë). P. Qiriazi u mor me çështje të ndryshme pedagogjike, arsimore e mësimore. Vlerëonte rëndësinë e diturisë, sidomos të shkollës dhe arsimit kombëtar, të cilin e konsideron si shtylla e kombit. U angazhua për zhvillim mendor, fizik e moral të nxënësve, për arsim shkencor. Ishte kundër shkollave të huaja në Shqipëri. Rëndësi të veçantë ka studimi i saj “Zhvillimi i shkollave në Perandorinë Turke dhe një sistem ideal për arsimin në Shqipëri” (1913), ku përveç zhvillimit historik të arsimit të shqiptarëve projektonte edhe një “sistem ideal” të arsimit në Shqipëri, i cili përfshin: kopshtet e fëmijëve, shkollat elementare, shkollat e dyta, universitetin, shkollat normale dhe shkollat speciale. (Xhafer Ismajli)

QIRIAZI (DAKO) Sevasti (1871-1949). Njëra nga mësueset e para shqiptare të arsimit të femrave, veprimtare e arsimit, pedagoge, Mësuese e Popullit. Lindi në Manastir, ku kreu ar-




SEVASTI QIRIAZI

simin fillor në shkollën greke të Shoqërisë Biblike. Studioi në Kolegjin Femëror Amerikan në Stamboll (1888-1891). Bashkë me Gjerashimin, në Korçë, më 1891 hapin shkollën e parë kombëtare shqipe për vajza, ku S. Qiriazi ishte mësuesja dhe drejtuesja e parë e saj. Studimet pedagogjike i vazhdoi në Kolegjin Oberlin në Ohajo (SHBA), ndërsa në vitin 1908 drejton sërish punën e Shkollës së Vajzave në Korçë. Mori pjesë në Kongresin Arsimor të Elbasanit (1909), ishte anëtare e komisionit për

shqyrtimin e teksteve shkollore të shoqërisë “Përparimi” në Korçë. U shqua sidomos për hartimin dhe botimin e teksteve shkollore shqipe, duke filluar nga viti 1912 me tekstin “Gramatika elementare për shkollat fillore”, për të vazhduar edhe me tekste të tjera, si: “Shkronjëtorja e gjuhës shqipe”, “Historia e kohës së moçme”, “Historia e kohës së mesme”, “Historia e kohës moderne”, “Numërorja”, “Fizika” etj. Ishte kryetare e Partisë Politike-Partia Kombëtare Shqiptare (1915) me seli në Vorçester (SHBA). Më 1918 u dërgoi një memorandum Fuqive të Mëdha për mosçnimin e tërësisë territoriale të Shqipërisë. Me Kristo Dakon (bashkëshorti i saj) dhe Parashqevinë e transferuan shkollën e vajzave nga Korça në Tiranë (Kamëz) dhe e quajtën Instituti arsimor “Kyrias”, ku vazhduan me punën mësimore deri në vitin 1933. S. Qiriazhi ishte luftëtare e shquar për arsimin e gruas shqiptare, për emancipimin dhe të drejtat e saj, duke filluar nga viti 1892. Ajo e madhëroi figurën e gruas, vlerën dhe rëndësinë e saj. (Xhafer Ismajli)

QORRAJ Snezhana (Snežana Ćoraj) (1950-). Gazetare. Lindi në Kragujevc (Serbi). Pas shkollimit fillor dhe të mesëm në qytete të ndryshme të Serbisë, studioi historinë e artit në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Beogradit. Nga viti 1974 filloi punë si gazetare në redaksinë në gjuhën serbe në Radiotelevizionin e Prishtinës, në të njëjtën kohë edhe si prezantuese e lajmeve dhe udhëheqëse e emisioneve të zhanreve të ndryshme. Gjatë punës si gazetare në RTP raportoi nga ngjarje të shumta dhe ishte autore e emisioneve dokumentare dhe reportazheve të shumta nga fusha të ndryshme, sidomos nga kultura. Në Radiotelevizionin e Kosovës punoi edhe pas luftës, si redaktore e programit në gjuhën serbe, deri më 2015, kur u pensionua. Është fituese e çmimeve dhe mirënjohjeve për punë profesionale. (Artan Krasniqi)

QORRAJ Xhevat (1945-). Aktor, regjisor. Lindi në Carrabreg të Deçanit. Karrierën e aktorit e filloi në Teatrin e Kombësive në Shkup (1965), ku punoi një kohë të shkurtër. Më pas mbaroi studimet për aktrim në Akademinë për Teatër, Film dhe TV në Beograd (1971). Një kohë të shkurtër punoi në Teatrin “Atelie 212” në Beograd, ndërsa më 1972 u bë anëtar i trupës së aktorëve të Teatrit Popullor




XHEVAT QORRAJ

“Sfinga e gjallë” të R. Qosjes në regji të L. Georgijevskit, për të cilin mori çmimin aktori më i mirë i ri në Takimet teatrore “Joakim Vujiç” në Shabac të Serbisë (1978). Realizoi me sukses edhe role në shfaqjet “Antigona”, “Non pasaran”, “Mizantropi”, “Shënimet e Gjon Nikollë Kazazit”, “Golgota”, “Verbimi i Samsonit”, “Varri i qyqës”, “Nëna shkon në parajsë”, “Garderobisti”, “Gjërat që s’preken”, “Teatri i vogël i Deli Ukës”, “Ventruset”, “Shpend Sokoli i Sokol Shpendit”, “Doktor Faustusi kobzi”, “Pallati i ëndrrave”, “Muzgu i lirisë” etj. Profili i Xhevat Qorraj si aktor u realizua më shumë në kinematografi, sidomos me rolin kryesor në filmin “Proka” (1984) dhe të Dinorit në filmin “Rojet e mjegullës” (1987), që të dy në regji të I. Qosjes, si dhe në rolin e Rrapit në “Njeriu prej dheu” (1984) në regji të A. Sopit. Xh. Qorraj bëri edhe regji të shfaqjeve teatrore: “Nata e fundit në Goli Otok” të M. Kajtazit (1992) dhe “Gof” të Anton Pashkut (1994). Për kontributin e tij në teatër dhe kinematografi, në vitin 2015 u nderua me çmimin për vepër jetësore “Bekim Fehmiu” nga Ministria e Kulturës, e Rinisë dhe e Sportit e Republikës së Kosovës. (Fadil Hysaj)

QOSJA Donat (1974-). Aktor. Lindi në Prishtinë. Kreu studimet për aktrim në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. Një pjesë të roleve i realizoi si student në Teatrin “Dodona”, ndërsa në Teatrin Kombëtar të Prishtinës luajti në shfaqjet: “Makbethi”, “Moulin Rouge”, “Ushitari nga Inishmori”, “Duke pritur Godonë”, “Fizikantët” etj. Për rolin e Aktorit II në “Shfaqja e fundit” të F. Hysajt u shpall aktori më i mirë në festivalin e shfaqjeve të pasluftës në Teatrin Kombëtar të Prishtinës (2001). Role të rëndësishme realizoi edhe në filmat “Dashuria e Bjeshkëve të Nemuna” të E. Kryeziut, “Kukumi”, “Vallja e çmendur” dhe “Tri dritare dhe një varje” të I. Qosjes. Për publikun u bë i njohur nga serialet televizive “Kafeneja jonë” dhe “Zyrja për gjithçka”. (Fadil Hysaj)

QOSJA Isa (1949-). Regjisor, pedagog, skenarist. Lindi në Vuthaj të Malit të Zi. Kreu studimet për aktrim në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prishtinë, Fakultetin e Arteve Dramatike për regji teatri dhe film në Universitetin e Beogradit (1980).



ISA QOSJA

Isa Qosja si në filmat e tij gjithashtu edhe në shfaqjet teatrale përdor një qasje regjisoriale alegorike. Filmi i tij “Proka” (1984) i solli çmimin “Grand Prix” në Festivalin e Kanës (1896), duke shënuar kështu depërtimin e parë ndërkombëtar të kinematografisë së Kosovës. Filmi i radhës “Rojet e mjegullës” (1987) ishte pjesëmarrës në një sërë festivalesh ndërkombëtare dhe fitues i çmimit për muzikën më të mirë në Festivalin “Pula 1987” të Kroacisë. Pjesëmarrjen në festivale ndërkombëtare e vazhdoi edhe me filmin “Kukumi” (2004), fitues i çmimit të parë për filmin më të mirë dhe për regjinë më të mirë në Festivalin e Filmit Shqiptar në Tiranë (2005), pastaj i çmimit special të jurisë në Festivalin e Filmit në Sarajevë (2005) dhe i çmimeve të tjera në Sofje (2006), Marok (2007), ndërsa me filmin “Tri dritare dhe një varje” në Festivalin ndërkombëtar të filmit në Sarajevë (2014) u shpërblye me çmimin “Cineuropa”. Pos filmave artistikë, I. Qosja punoi edhe filma dokumentarë si: “Stafeta ‘80” (1980), “Dy rrëfime dhe një nuse” (1999), “Muzgu i tokave tona” (2001), pastaj filmat televizivë: “Vesa” (1994), “Gjurmët”, “Vallja e çmendur” (1998), “Ringjallja” (2000) etj. Realizoi edhe disa filma të shkurtër, ndër të cilët edhe “Status Quo”, që u përzgjedh në programin zyrtar të Festivalit Ndërkombëtar të Filmit në Karlovy Vari (1980). Është autor edhe i disa skenarëve për filma të metrazhit të gjatë. Në punën e tij prej regjisorit një vend të rëndësishëm zënë shfaqjet teatrale: “Ah, Xho” (1980), “Varri i qyqes” (1984), “Shpend Sokoli i Sokol Shpendit” (1988), “Shqiptari me duar në xhepa” (1997), “Zeka i Zi” (2007), “Monodramë për mua dhe Zotin” (1999), pastaj “Ëndrra e qenit” (2002) dhe “Grafitet” (2006), si dhe shfaqje të tjera si “Uuh” (2008), “Fizikantët” (2011), “Karvani i buburrecave” (1998) etj. I. Qosja dha një kontribut të çmuar edhe në themelimin dhe udhëheqjen e de-

partamentit të filmit në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës, ku punoi si mësuesdhënës i lëndës regji filmi. Për kontributin e tij në artin kinematografik Ministria e Kulturës, e Rinisë dhe e Sportit në vitin 2014 e nderoi me çmimin për vepër jetësore “Bekim Fehmiu”. (Fadil Hysaj)

QOSJA Ismail (1954-) Skulptor. Lindi në Vuthaj (Mali i Zi). Kreu Akademinë e Arteve Figurative, drejtimi i skulpturës, në Prishtinë (1977). Organizoi ekspozitë personale më 1981, në Foajeun e Teatrit Popullor në Prishtinë më 1982, pastaj në Galerinë e Shoqatës së Artistëve Figurativë të Kosovës në Grozhnjan, ndërsa mori pjesë edhe në disa ekspozita kolektive (Salloni Pranveror i Kosovës, Salloni i Nëntorit etj.) Është laureat i çmimit të Sallonit Pranveror të vitit 1979, pastaj i çmimit të Sallonit të Nëntorit të vitit 1980, i çmimit të Sallonit Pranveror të vitit 1984, që të gjitha në Prishtinë. Që nga vitet '80 jeton dhe vepron në SHBA. (Luan Mulliqi)

QOSJA Rexhep (1936-). Shkrimtar, historian i letërsisë, profesor universiteti, akademik. Lindi në Vuthaj të Malit të Zi. Kreu shkollimin fillor dhe të mesëm në Vuthaj dhe në Guci. Në



REXHEP QOSJA

Prishtinë e kreu Shkollën Normale, ndërsa studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe i kreu në Fakultetin Filozofik të Prishtinës. Më 1967 filloi punë si asistent në Institutin Albanologjik të Prishtinës, ndërsa më 1968-69 kreu studimet pasuniversitare në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Beogradit. Më 1969 u zgjedh bashkëpunëtor shkencor në Institutin Albanologjik të Prishtinës. Në vitin 1971 mbrojti tezën e doktoratës mbi jetën dhe krijimtarinë e Asdrenit. Pas doktorimit u ngrit në bashkëpunëtor të lartë dhe më pas në këshilltar shkencor në këtë institut, si dhe u zgjedh profesor inordinar dhe më pas profesor ordinar në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Në periudhën 1972-1981 ka qenë drejtor i Institutit Albanologjik, pastaj shef disavejçar i degës së gjuhës dhe letërsisë shqipe në Fakultetin Filozofik, si dhe kryeredaktor i revistës letrare “Jeta e re”. Veprat e para i botoi nga fusha e kritikës

dhe studimeve letrare, për të vazhduar pastaj me studime për historinë e letërsisë shqipe, prozë, drama, publicistikë etj. Nga fusha e kritikës dhe e studimeve letrare botoi veprat: “Episode letrare” (1967), “Dialogje me shkrimtarët” (1968), “Kritika letrare” (1969), “Kontinuitete” (1972), “Panteoni i rralluar” (1973), “Shkrimtarë dhe periudha” (1975), “Prej tipologjisë deri te periodizimi” (1979), “Nocione të reja albanologjike” (1983), “Prej letërsisë romantike deri te letërsia moderne” (2006) etj. Vepra e tij shkencore përbëhet edhe nga studime monografike, siç janë: “Asdreni - jeta dhe vepra e tij” (1972), “Porosia e madhe” (1986), studim monografik për Naim Frashërin, si dhe studimet e shumta monografike për disa autorë të rëndësishëm të letërsisë shqipe. Po kështu, vepra sintezë në tri vëllime “Historia e letërsisë shqipe - Romantizmi I-II-III” (1984-1986), konsiderohet ndër studimet më të plota për periudhën e romantizmit shqiptar. Fushë e interesimit të tij janë periudha e Rilindjes Kombëtare, vlerësimi i veprave të autorëve më të rëndësishëm të letërsisë shqipe, problemet e periodizimit të letërsisë etj. Në fushën e prozës, R. Qosja në romanin “Vdekja më vjen prej syve të tillë” (1974) trajton fatin e popullit dhe të intelektualit shqiptar në Kosovë në rrethanat shoqërore dhe politike të Kosovës dhe të ish-Jugosllavisë. Pas një periudhe të gjatë i rikthehet sërish prozës dhe boton veprat “Një dashuri dhe shtatë faje” (2001), “Nata është dita jonë” (2007), “Bijtë e askujt” (2010) etj. Në fushën e dramaturgjisë botoi librin me drama “Mite të zhveshura” (1978). Ndërkaq kontributin e tij në fushën e publicistikës e ka dhënë me veprat që i kushtohen çështjes shqiptare në përgjithësi dhe çështjes së Kosovës, në veçanti, siç janë: “Populli i ndaluar” (1990), “Strategjia e bashkimit kombëtar” (1992), “Çështja shqiptare - historia dhe politika” (1994), “Fjalori demokratik” (1997), “Paqja e përgjakshme” (1999) etj. Gjithashtu, R. Qosja ka shkruar disa vepra të karakterit polemik “Morfologjia e një fushate” (1980), “Realiteti i shpërfillur” (2006), “Të vërtetat e vonuara” (2006) etj. Viteve të fundit ka filluar botimin e ditarëve të tij me titullin “Dëshmitar në kohë historike”, duke filluar nga viti 1966 e këndej. Deri më tani i ka botuar gjashtë vëllime të kësaj serie. Në vitin 2010 nga Instituti Albanologjik i Prishtinës u botua kompleti i veprave të tij në 29 vëllime. Veprat e Rexhep Qosjes janë përkthyer në gjuhë të

ndryshme të botës. Është marrë edhe me veprimtari politike. Në periudhën 1998-2000 drejtoi një subjekt politik dhe për një kohë bënte pjesë në Këshillin Transitor të Kosovës gjatë viteve të para të qeverisjes së UNMIK-ut në Kosovë. Është anëtar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës që nga themelimi i saj dhe anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Për krijimtarinë e tij është nderuar me çmime, dekorata dhe mirënjohje. (Sali Bashota)

QYPËRLINJTË. Familje shqiptare vezirësh osmanë me origjinë nga fshati Roshnik i rrethit të Beratit. Duke filluar nga gjysma e dytë e shek. XVII, kjo familje i dha Perandorisë Osmane pesë Vezirë të Mëdhenj (kryeministra): Mehmet Pasha (1656-1661), Ahmet Pasha (1661-1676), Mustafa Pasha (1689-1691), Hysejin Pasha (1697-1702), Numan Pasha (qershor-gusht 1710). Për shkak se e drejtuan shtetin osman për gjysmë shekulli, nga shumë bashkëkohës kjo periudhë u mbiquajit “Periudha e Qypërlinjve”. Njihen për autoritet dhe kompetencë në drejtimin e shtetit osman. Në kohën e Qypërlinjve, pikërisht falë interesimit të tyre të veçantë për të ngritur në pushtet bashkëkombësit e tyre, u fuqizuan disa nga oxhaqet shqiptare që patën rol tejet të rëndësishëm në jetën politike, shoqërore dhe ekonomike të vendit. Gjithashtu edhe principata shqiptare e Gjirkajve në Moldavi dhe Vllahi ka gëzuar mbështetjen e Qypërlinjve. Rol politik të rëndësishëm kjo familje ka pasur në kohën e luftërave habsburge-osmane dhe veneto-osmane në fund të shek. XVII dhe në tri dekadat e para të shek. XVIII. Gjatë tre shekujve të fundit nga gjiri i kësaj familjeje kanë dalë edhe personalitete të tjera të shquara që kanë shërbyer në nivele të larta të administrimit të shtetit dhe në diplomacinë osmane. Gjatë gjysmës së parë të shek. XX, në lëmin e studimeve të historisë së kulturës turke spikat Fuat Qypërlinju. (Dritan Egro)

QYQALLA Hava (1960-2015). Gjuhëtare, profesore. Lindi në Trudë të Prishtinës. Shkolën fillore e kreu në vendlindje, të mesmen në Prishtinë, studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe i ndoqi në Fakultetin e Filologjisë në Prishtinë. Po aty kreu studimet pasuniversitare dhe mbrojti tezën e doktoratës “Sistemi foljor i shqipes në veprën e Pjetër Bogdanit”. Punoi si

mësimdhënëse e shkollës së mesme në Prishtinë. Më 1988 u zgjodh asistente në degën e gjuhës dhe të letërsisë shqipe në Fakultetin e Filologjisë, pastaj ligjëruese dhe profesor asistent (2011).

Botoi një numër artikujsh e studimesh gjuhësorë në Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoni. Është marrë me gramatikën historike dhe tekstet e vjetra të shqipes. (Agnesa Hasimja)

R

RAÇA Shkelzen (1951-2014). Historian. Lindi në Skënderaj. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Prishtinë, ku mbaroi edhe studimet për histori në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës.



SHKELZEN RAÇA

Po në këtë fakultet kreu studimet pasuniversitare dhe mbrojti tezën e magjistraturës për Lëvizjen Kombëtare Shqiptare dhe Revolucionin xhonturk (1977), ndërsa më 1987 mbrojti tezën e doktoratës mbi marrëdhëniet shqiptaro-greke në periudhën 1829-1881. Specializoi paleografinë greke në Athinë dhe greqishten e re. Për një kohë të shkurtër punoi mësimdhënës në shkolla të mesme, ndërsa nga viti 1977 u punësua në degën historisë të Institutit Albanologjik të Prishtinës. Pas luftës (1999) disa vjet punoi si zyrtar i lartë në Zyrën Greke në Prishtinë. La këto vepra të botuara: “Marrëdhëniet shqiptaro-greke 1829-1881” (1990), “Shtegtimet dhe ngulimet e shqiptarëve në Greqi në shek. XIII-XVI” (2004), “Gjurmime në historinë shqiptare” (2009). Sh. Raça mori pjesë në simpoziume dhe konferenca shkencore në Kosovë dhe jashtë, ku trajtoi kryesisht raportet shqiptaro-greke. (Alban Dobruna)

RAÇA-HOXHA Shpresa (1953-). Professore universiteti. Lindi në Mitrovicë, shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në vendlindje, ndërsa studimet e larta për gjuhë dhe letërsi angleze i kreu në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Studimet pasuniversitare i mbaroi më 1986, ndërsa titullin e doktorit të shkencave filologjike e mori në vitin 2003. Në Universitetin e Prishtinës filloi të punonte

që nga vitet 1975, si lektore e gjuhës angleze në Fakultetin Filozofik, ndërsa prej vitit 1983 kaloi në marrëdhënie të përhershme pune në Fakultetin Ekonomik. Ligjëroi edhe në Fakultetin e Makinerisë dhe njëkohësisht vazhdoi angazhimet edhe në katedrën e gjuhës dhe të letërsisë angleze. Përveç angazhimit në procesin mësimor, ka ushtruar edhe detyra menaxheriale në Universitet dhe ka botuar një numër punimesh shkencore, përfshirë disa përkthime dhe monografinë “Kontributi i Uilljëm Martin Likut në fushën e studimeve albanologjike”. Së fundi ka botuar veprën “Fjalor fjalësh e shprehjesh turke”. (Myrvete Badiviku).

RAÇKI Franjo (Rački) (1828-1894). Historian kroat. Lindi në Fuzhinë të Kroacisë. Studioi për teologji dhe u doktorua në Vjenë (1855). U mor me hulumtimin e dokumenteve mesjetare glagolike, latine dhe bizantine. Që në moshën rinore u përfshi në Lëvizjen Ilire të kroatëve. Ishte njëri ndër themeluesit e Akademisë Jugosllave të Shkencave dhe të Arteve (JAZU) dhe kryetar i parë i saj. Pas hulumtimit në arkiva dhe biblioteka të Romës të dokumenteve për historinë kroate, më 1868 botoi veprën “Bogumilët dhe Paterentët”. Ishte redaktor i 26 vëllimeve të revistave shkencore e kulturore me titull: “Starine JAZU”, dhe “Rad JAZU”, ku mund të ndeshen edhe njoftime interesante për historinë e Kosovës gjatë mesjetës. Në këtë kuadër duhet veçuar studimi “Beteja e Kosovës. Shkaqet dhe pasojat” (1889). Nga fundi i jetës punoi për mbledhjen e burimeve historike për përmbledhjen: “Kodeksi diplomatik i Mbretërisë Kroate, Dalmatine dhe Sllavone” (Codex Diplomaticus Regni Croatiae, Dalmatiae et Slavoniae), edicion që nuk arriti ta përfundonte dhe që më

pas e vazhduan historianët Tadija Smiçklas dhe Milan Shuflaj. (Muhamet Mala)

RADAVCI. Fshat i tipit të dendur, 8 km në verilindje të qytetit të Pejës, në rrugën Pejë-Rozhajë. Shtrihet në afërsi të burimit të Drinit të Bardhë, në lartësi mbidetare 540 m. Sipërfaqja e territorit të fshatit është 558 ha, nga e cila gjysma janë pyje, pjesa tjetër ara dhe më pak livadhe. Popullsia merret kryesisht me bujqësi. Në galerinë e majtë të shpellës së Radavcit, te burimi i Drinit të Bardhë janë gjetur mbeturinat e gjallesave parahistorike, një pjesë e nofullës dhe një dhemb i ariut të shpellës. Është vendbanim i vjetër, në të cilin janë gjetur mbeturinat e një fortifikate antike. Muret e kësaj fortifikate janë të ndërtuara nga gurët e thyer dhe llaçi gëlqeror, me mjaft zall të trashë e vende-vende me tulla të pjekura, me brendinë në formën e kubit. Me emrin Radavça dhe me 19 shtëpi përmendet në regjistrin kadastral osman të sanxhakut të Shkodrës të vitit 1485. Derisa në vitin 1921 kishte 334 banorë, në vitin 2011 Radavci ka 1,352 banorë. Nga objektet e standardit shoqëror ka shkollën 9-vjeçare, stacionin shëndetësor, dyqanet tregtare dhe objekte turistike. (Bajram Kafexholli)

RADIO “DUKAGJINI”. Radio private e pavarur, me frekuencë nacionale, e cila u themelua në vitin 1999 nga Korporata “Dukagjini”. Nisi me 17 orë program, nga ora 8.00 e mëngjesit deri në orën një pas mesnate. Në vitin 2015 transmetonte 21 orë program muzikor e foljor. Në fillim transmetoi program si radio lokale, për të marrë më vonë licencën e frekuencave nacionale, me shtrirje në tërë territorin e Kosovës. Programi i Radio Dukagjinit përbëhet nga emisione informative, zbavitëse, muzikore etj. Transmeton program nga dy studio, në Prishtinë dhe Pejë. Është njëri ndër transmetuesit më të mëdhenj radiofonik në Kosovë dhe konsiderohet ndër radiostacionet me dëgjueshmërinë më të madhe. Duke pasur frekuencë nacionale dhe duke ofruar program alternativ, ka arritur të dallohet nga radiostacionet e tjera të Kosovës. (Artan Krasniqi)

RADIO PRISHTINA. Radio shtetërore e ish-Jugosllavisë në Kosovë. U themelua pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, më 1945, në Prizren dhe u emërtua Radio-Prizreni. Pak pas themelimit u transferua në Prishtinë,

e cila u bë qendër administrative dhe politike e Kosovës. Në fillim transmetoi program vetëm në gjuhën serbe dhe në gjuhën shqipe, kurse më vonë transmetoi program edhe në gjuhën turke dhe rome. Struktura gjuhësore e programit përcaktohej sipas strukturës etnike të popullsisë së Kosovës. Radio Prishtina i kishte dy kanale: Radio Prishtina, programi i parë dhe Radio Prishtina, programi i dytë. Ligjshmërisht ishte nën mbikëqyrjen e Kuvendit të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës. Në vitin 1974 u bë pjesë e shtëpisë informative të Radiotelevizionit të Prishtinës, në përbërjen e të cilit, përveç Radio Prishtinës, ishte edhe Televizioni i Prishtinës, i cili sapo ishte themeluar. Radio Prishtina e arriti kulmin e zhvillimit profesional e teknik pas vitit 1974, kur Kosova njohu autonomi më të gjerë në kuadër të federatës Jugosllave. Në korrik të vitit 1990, pas shuarjes së autonomisë së Kosovës, Serbia i mbylli me dhunë dy mediumet atëherë më me ndikim në Kosovë, Radio Prishtinën dhe Televizionin e Prishtinës. Me dëbimin e shqiptarëve nga puna, Radio Prishtina u vu plotësisht në shërbim të politikës luftënxitëse të Serbisë. Programi në gjuhën shqipe u reduktua vetëm në disa emisione lajmesh, të përkthyer nga gjuha serbe. Pas çlirimit të Kosovës, në qershor të vitit 1999, punëtorët e Radio Prishtinës provuan ta rifillonin punën, por nuk u lejuan nga KFOR-i, me arsyetim se objektet mund të ishin të minuara nga policia dhe ushtria serbe. Punëtorët e Radio Prishtinës provuan ta funksionalizonin sërish këtë medium, por nuk arritën ta bënin këtë, pasi nuk kishin mbështetje as nga administrata e përkohshme ndërkombëtare dhe as nga Qeveria e Përkohshme e Kosovës. Në shtator të vitit 1999, ndërtesat dhe resurset e tjera të Radio Prishtinës iu dhanë në shfrytëzim Radio Kosovës së sapothemeluar, kurse Radio Prishtina nuk arriti më të riaktivizohet dhe t'i shfrytëzojë resurset e saj. (Hyra Tejeci)

RADIO TELEVISIONI I PRISHTINËS (RTP). (Arkitektura.) Në vitin 1965 nga firma projektuese “Slovenija Projekt” nga Lubjana me arkitekt O. Gaspari u punua projekti i ndërtesës së Radio-Prishtinës me sipërfaqe prej 7,000 m². Arkitektura e ndërtesës i takon modernizimit internacional, me strukturë kompozicionale të përbërë nga kulla kryesore vertikale me fasadë të kombinuar me materiale të tullës dhe betonit



GODINA E RADIOS

natyror, me elemente të theksuara vertikale dekorative, planimetri karakteristike të trekëndëshit barabrinjës, me sipërfaqe prej 250 metrash katrorë, me katet B+P+10 dhe lartësi rreth 42 metra, me sipërfaqe të tërësishme prej 3,000 metrash katrorë. Pjesa e dytë e ndërtesës është kompozicioni horizontal me etazhitet P+1 dhe sipërfaqe prej 4,000 metrash katrorë. Në katin e parë të pjesës horizontale është e vendosur salla e madhe e prezentimeve skenike dhe koncertale me kapacitet prej 200 ulësesh, me hapësirat përcjellëse të shikuesve dhe të artistëve, me salla për ushtrime të instrumentistëve dhe solistëve, hapësira për prova të dramës si dhe 5 studiove të incizimit me hapësira përcjellëse të teknikës. Në vitin 1983 u punua projekti i adaptimit të katit përdhës nga Enti për Urbanizëm dhe Projektim në Prishtinë, i cili ishte shfrytëzuar për vendparkime të automjeteve zyrtare të TVP-së. Me kërkesë të investitorit për rritje të kapacitetit të hapësirave për nevoja funksionale të RTP-së, edhe ky kat shndërrohet në hapësira për shërbime të përgjithshme, produksion, sallë të mbledhjeve me sallon, restorant dhe kuzhinë. Prej vitit 1999 deri më sot salla koncertale është jashtë funksionit, kurse në hapësirat e kullës administrative është vendosur Radio-Kosova. (Vlora Navakazi)

RADIOT NACIONALE, RAJONALE DHE LOKALE. Radio me shtirje të ndryshme frekuencash, të cilat funksionojnë me licencën e Komisionit të Pavarur të Medieve të Kosovës. Deri në vitin 2016 në Komisionin e Pavarur të Medieve janë të licencuar gjithsej 82 radio, 4 prej tyre kanë frekuencë nacionale (Radio Kosova 1, Radio Kosova 2, Radio 21 dhe Radio Dukagjini), 14 janë radio rajonale, kurse 64

janë radio lokale. Nga numri i përgjithshëm, 37 radio transmetojnë program në gjuhën shqipe, 16 në gjuhën serbe, 3 radio lokale transmetojnë program në gjuhën boshnjake, 2 radio lokale në gjuhën turke, 1 në gjuhën gorane, 1 në gjuhën rome, kurse 20 radio transmetojnë program në dy apo tri gjuhë. Radiot lokale në Kosovë u krijuan në vitet '70 të shek. XX nga kuvendet komunale të qyteteve: Mitrovicë, Prizren, Gjilan, Gjakovë, Pejë dhe Ferizaj. Ato financoheshin nga komunat përkatëse dhe nga reklamat. Funksionuan deri në korrik 1990, kur në to u vunë masat e dhunshme të Serbisë. Mbas vitit 1999 kishte një shtrirje të gjerë të radiove lokale në gjithë Kosovë, në gjuhën shqipe dhe në gjuhët e minoriteteve. Radio Kosova 1 dhe Radio Kosova 2 transmetojnë program në pesë gjuhë (shqip, serbisht, turqisht, boshnjakisht dhe në gjuhën rome). Funksionimi i radiove nacionale, rajonale dhe lokale rregullohet me Ligjin nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Medieve. Përgjatim bëjnë Radio Kosova 1 dhe Radio Kosova 2, funksionimi i të cilave rregullohet me Ligjin për Radiotelevizionin e Kosovës. (Hyra Tejeci)

RADIOT NACIONALE. Radio me shtrirje frekuencash në tërë territorin e Kosovës, të licencuara nga Komisioni i Pavarur të Medieve. Në Kosovë funksionojnë 4 radio me frekuencë nacionale: Radio Kosova 1, Radio Kosova 2, Radio 21 dhe Radio Dukagjini.

Radio Kosova 1 është njësi e transmetuesit të vetëm publik, Radiotelevizionit të Kosovës (RTK). U themelua në vitin 1999 nga Organizata Europiane për Siguri e Bashkëpunim (OSBE) dhe u menaxhua nga Unioni Europian i Transmetuesve (European Broadcasting Union-EBU). Prodhon dhe transmeton program në gjashtë gjuhë: në gjuhën shqipe, angleze, serbe, turke, boshnjake dhe rome. Programet e saj i transmeton në rrjetin tokësor dhe në rrjetin satelitor. Është e vendosur në ndërtesën e ish-Radio Prishtinës, në Prishtinë. Financohet nga Kuvendi i Kosovës, kurse menaxhohet nga menaxhmenti i zgjedhur nga bordi i drejtorëve, anëtarët e të cilit zgjidhen nga Kuvendi. Funksionimi i saj rregullohet me Ligjin për Radiotelevizionin e Kosovës.

Radio Kosova 2 është njësi e transmetuesit publik, Radiotelevizionit të Kosovës (RTK). U themelua në vitin 1999 me emrin "Radio Blue Sky", nga Fondacioni zviceran "Hirondelle"

(organizatë joqeveritare e gazetarëve dhe ndihmës profesionale humanitare). Pak kohë pas themelimit filloi të funksionojë në kuadrin e Misionit të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK). Në vitin 2000 u transformua si program i dytë i Radio Kosovës. Në vitin 2012 u emërtua “Radio Kosova 2”. Tani është pjesë e Radiotelevizionit të Kosovës (RTK). Transmeton program në rrjetin tokësor dhe satelitor. Është vendosur në ndërtesën e ish-Radio Prishtinës, në Prishtinë. Financohet nga Kuvendi i Kosovës, kurse menaxhmenti zgjidhet nga bordi i drejtorëve, të cilët zgjidhen nga Kuvendi i Kosovës. Edhe funksionimi i saj rregullohet me Ligjin për Radiotelevizionin e Kosovës.

Radio 21 është radio nacionale me seli në Prishtinë, e themeluar në vitin 1999. Në fillim ka nisur transmetimin e programit përmes internetit. Një kohë lajmet e kësaj radioje janë transmetuar edhe përmes frekuencave të BBC-së. Gjatë kohës së sulmeve ajrore të NATO-s ndaj Serbisë, ka filluar transmetimin e programit nga Shkupi. Pas luftës, në vitin 1999, e ka rifilluar punën në Prishtinë.

Radio Dukagjini është radio me frekuencë nacionale, me seli në Pejë. U themelua në vitin 1999 nga kompania “Dukagjini”. Transmeton program në gjuhën shqipe, nga studiot e saj në Pejë dhe në Prishtinë. Disa hulumtime të kryera nga kompani të specializuara e kanë nxjerrë si radion më të dëgjuar në Kosovë. (Hyra Tejeci)

RADIOT RAJONALE. Radio me shtrirje frekuencash në rajone të ndryshme të Kosovës, të licencuara nga Komisioni i Pavarur i Medieve të Kosovës. Ky komision deri në vitin 2016 ka licencuar 14 radio rajonale, nga të cilat më të njohurat janë:

Radio Ballkan, radio me frekuencë rajonale, me seli në Prizren, që transmeton program në gjuhën turke, shqipe, boshnjake dhe rome.

Radio Ferizaj, u themelua nga Kuvendi Komunal i Ferizajt më 1967. Në vitin 1990 u mbyll nga Serbia. Pas luftës, më 1999 e ka rinisur punën sërish. Prej vitit 2002 funksionon si organizatë joqeveritare. Është e regjistruar si radio rajonale.

Radio Gjakova, u themelua nga Kuvendi i Komunës së Gjakovës më 1979. Më 1991 u mbyll me forcë nga pushteti serb. U riaktivizua menjëherë pas luftës më 1999. Sot e ka statusin e organizatës joqeveritare.

Radio “Kosova e Lirë”, është radio rajonale, e themeluar nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së në nëntor të vitit 1998. Gjatë luftës ka transmetuar program nga malet e Berishës, në pjesën qendrore të Kosovës. Pas luftës është zhvendosur në Prishtinë dhe ka statusin e organizatës joqeveritare.

Radio KIM (Kim - akronim i emërtimit “Kosovo i Metohija”), është radio rajonale, me seli në Çagllavicë, afër Prishtinës. Transmeton program në gjuhën serbe dhe në gjuhën rome. *Radio KM* (KM - akronim i “Kosovska Mitrovica”) Është radio rajonale, me seli në pjesën veriore të Mitrovicës. Transmeton program në gjuhën serbe.

Radio Mitrovica, u themelua më 1999 nga Organizata joqeveritare “Mitrovica”. Transmeton program në gjuhën shqipe dhe në gjuhët e minoriteteve.

Radio Peja, është radio rajonale e themeluar në vitin 1975 nga Kuvendi Komunal i Pejës. Në vitin 1990 pushteti serb i dëboi shqiptarët nga puna dhe e pagëzoi “Radio Metohija - studio Peç”. Në vitin 2000 u riaktivizua me ndihmën e disa organizatave ndërkombëtare në Kosovë. Transmeton program në gjuhën shqipe, boshnjake, turke dhe rome.

Radio Prizreni është radio rajonale e themeluar nga Kuvendi i komunës së Prizrenit në vitin 1975. Ka transmetuar program në gjuhën shqipe, serbe, turke, boshnjake dhe rome. Në vitin 1991 redaksia e programit në gjuhën shqipe u mbyll nga pushteti serb. Pas luftës, më 1999, u riaktivizua përsëri. Nga viti 2002 funksionon në kuadrin e Shoqatës për përparimin e medieve “Shadërvani”. Transmeton program në gjuhën shqipe dhe turke.

Radio Vala Rinore, është radio rajonale me seli në Prishtinë. Punën e ka nisur në vitin 2000. Në vitin 2001 nisi transmetimin edhe përmes internetit, kurse në vitin 2010 filloi edhe transmetimin digjital. (Hyra Tejeci)

RADIOTELEVIZIONI I KOSOVËS (RTK). Transmetues publik, i themeluar në shtator të vitit 1999, nga Organizata Europiane për Siguri e Bashkëpunim (OSBE). Në fillim u menaxhua nga Unioni Europian i Transmetuesve (European Broadcasting Union-EBU), kurse një vit më vonë (2011) menaxhimi i RTK-së i kaloi bordit të drejtorëve. RTK-ja ka 4 kanale televizive, 2 prej të cilave janë të licencuara si

televisione nazionale (RTK 1 dhe RTK 2) dhe 2 kanale të radios, po ashtu të licencuara si radio nazionale (Radio Kosova 1 dhe Radio Kosova 2). RTK 1 prodhon dhe transmeton program në pesë gjuhë: shqipe, serbe, turke, boshnjake dhe rome. Programet e RTK-së transmetohen në rrjetin tokësor dhe në atë satelitor. RTK 2 prodhon dhe transmeton program në gjuhën serbe. RTK 3 është kanal informativ, ku transmetohen kryesisht lajme dhe programe lidhur me temat aktuale në vend, kurse RTK 4 është kanal i destinuar kryesisht për programe dokumentare dhe kulturore, artistike dhe argëtuese. RTK-ja financohet nga buxheti i Kosovës, kurse funksionimi i tij është i rregulluar me një ligj të veçantë, Ligjin 2011/04-L-046 për Radiotelevizionin e Kosovës. Sipas ligjit, drejtohet e mbikëqyret nga bordi i drejtorëve, anëtarët e të cilit zgjidhen nga Kuvendi i Kosovës, kurse menaxhohet nga menaxhmenti, i cili zgjidhet nga bordi. RTK-ja i shfrytëzon objektet dhe resurset e tjera të ish-Radiotelevizionit të Prishtinës (RTP), i cili nuk është funksionalizuar pas përfundimit të luftës në vitin 1999. (Hyra Tejeci)

RADIOTELEVISIONI I PRISHTINËS (RTP). Shtëpi informative shtetërore e periudhës së autonomisë së Kosovës, e themeluar në vitin 1974 nga Kuvendi i Krahinës Socialiste



Autonome të Kosovës. RTP-ja ishte "organizatë e përbërë e punës së bashkuar", e përbërë nga 5 njësi: Televizioni i Prishtinës (i themeluar i fundit), Radio Prishtina, Produksioni muzikor,

Transmetuesi e lidhjet dhe Shërbimi i parapagimit. RTP-ja funksiononte në bazë të Ligjit të punës së bashkuar, por kishte trajtim si organizatë me rëndësi të veçantë shoqërore e politike. Formalisht, RTP-ja mbikëqyrej nga Kuvendi, por rol vendimtar në politikën redaktuese kishte Komiteti Krahinor i Lidhjes së Komunistëve. RTP, si medium me ndikim të jashtëzakonshëm te publiku, ka pasur një ndikim të madh edhe në procesin e zhvillimit të përgjithshëm shoqëror, kulturor e arsimor në Kosovë dhe në krijimin dhe afirmimin e vlerave kulturore e artistike. Në vitet '70 e '80

RTP-ja kishte një ndikim të konsiderueshëm edhe në zhvillimet politike. Por kulmin e ndikimit e arriti në fund të vitit 1989, në periudhën e debateve publike lidhur me ndryshimet kushtetuese që po imponoheshin nga Serbia dhe sidomos në vitin 1990, kur nisi artikulimi publik i vullnetit të popullit të Kosovës për realizimin e të drejtës për vetëvendosje dhe për status të barabartë me republikat tjera të Federatës Jugosllave. Duke parë ndikimin e RTP-së në afirmimin e kërkesës për vetëvendosje, Serbia ndërpreu me dhunë programet e radios dhe të televizionit dhe i largoi nga puna pjesën dërrmuese të punëtorëve shqiptarë. Prej vitit 1990 deri në vitin 1999, kur Serbia u detyrua të tërhiqej nga Kosova, RTP-ja transmetonte ekskluzivisht programe në gjuhën serbe dhe disa emisione të shkurtra lajmesh të përkthyer nga gjuha serbe në gjuhën shqipe, turke dhe rome. Pas përfundimit të luftës në vitin 1999, punëtorët e RTP-së nuk arritën të riaktivizojnë këtë medium, pasi Misioni i Përkohshëm i Kombeve të Bashkuara dhe misionet e tjera ndërkombëtare, si edhe Qeveria e Përkohshme e Kosovës, nuk u dhanë mbështetje. Në vend të RTP-së u themelua Radiotelevizioni i Kosovës (RTK), të cilit iu dhanë në shfrytëzim ndërtesat dhe resurset e tjera të RTP-së. (Hyra Tejeci)

RADIOTELEVISIONI-21. Transmetues privat, njëra nga mediet elektronike me licencë kombëtare në Kosovë. U themelua si radio e parë shqiptare në internet (11 maj 1998) dhe



pastaj edhe si Produksioni-21. Në janar të vitit 1999, Radio-21 fillon transmetimin e 2 edicioneve 15 minutash në BBC World, ndërsa dokumentarët e Produksionit-21 u shfaqën në

"CNN World Report". Më 24 mars 1999 zyrat e Radios-21 u bastisën nga policia serbe dhe radioja e pushoi punën deri më 7 prill 1999, kur jepet informacioni i parë nga Maqedonia. Më 11 maj 1999, Radio-21 rifillon programin e plotë në internet me 7 edicione lajmesh në gjuhën shqipe dhe 5 edicione lajmesh në gjuhën angleze. Më pas filloi transmetimin e programit të vet në valë të shkurta, përmes Radio-Hollandës, nga 150 minuta në ditë, duke filluar nga

ora 22:00. Radio-21 u kthye në Kosovë më 14 korrik 1999, e ndihmuar nga KFOR-i anglez. Të njëjtën ditë fillon transmetimin e programit 24 orësh në valë të mesme. Një vit më vonë, më 22 shtator të vitit 2000 fillon transmetimi i programit TV-21 përmes satelitit, ndërsa prej 22 nëntorit të vitit 2000 përmes rrjetit tokësor KTTN. Brenda më pak se një viti, TV-21 arriti të transmetojë 24 orë program në ditë. Radio-21 dhe TV-21 janë media historike me licencë kombëtare. Në vitin 2015 "Company-21" themeloi edhe TV-21 në Maqedoni, i cili bart gjithashtu licencë kombëtare të transmetimit. Në dhjetor të vitit 2013, RTV-21 filloi transmetimin në HD si dhe transmetimin eksperimental tokësor digjital. (Ibrahim Berisha)


RADOGOSHI Kadrush (1948-). Shkrimtar. Lindi në Gjakovë. Kreu shkollimin fillor dhe të mesëm në vendlindje, ndërsa studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Prishtinë. Një kohë punoi si mësimdhënës i gjuhës shqipe në shkollë të mesme të Gjakovës. U burgos dhe u dënua për propagandë antijugosllave. Me shkrime filloi të merret që nga vitet '70. Shkruan poezi, prozë, dramë dhe ese, kritikë letrare dhe artikuj studimorë për letërsinë. Vepra të botuara: "Në mes të heshtjes e këngës" (1981), "Në udhëkryq" (1984), "Poetika e romanit bashkëkohor shqiptar" (1985), "Nekrologji për Sodomën" (1991), "Jeta artistike e Ilir Shkretës" (1993), "Interpretime" (1993), "Heraldika e pikëllimit" (1997), "Homo Dardanicus" (2001), "Adem Jashari dhe vdekja" (2001), "Nëpër universin letrar" (2003), "Pikon çati e shpirtit" (2004), "Orfeu nga Vendenisi" (2005), "Nëpër rrathët e ferrit serb" (2000), "Pikëllim i buzëqeshur" (2006), "Semantika e bregut tjetër" (2008), "Çabrat antologjia - seancë e përsëritshme" (2008). Jeton në SHBA. (Nazmi Rrahmani)

RADONIQ (Radonić) Jovan (1873-1956). Historian, bizantolog, bibliotekar, akademik. Lindi në Mol (Austro-Hungari, sot në Vojvodinë). Studioi në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Vjenës, ku dhe mori gradën e doktorit të shkencave për filozofi (1896). Punoi si bibliotekar në Novi-Sad, ndërsa më pas u zgjodh profesor i historisë së mesjetës në Universitetin e Beogradit (1919). Më 1948 u bë anëtar i rregullt i Akademisë Serbe të Shkencave dhe të Arteve. Shkroi vepra shkencore për historinë mesjetare të Ballkanit,

përfshirë edhe historinë e shqiptarëve: "Europa Perëndimore dhe vendet e Ballkanit përball turqve në gjysmën e parë të shekullit XV" (1905), "Gjuragj Brankoviqi, despot i Ilirikut" (1929), "Gjergj Kastrioti Skënderbeu dhe Arbëria në shek. XV" (1942) etj. Në veprën për Skënderbeun janë përfshirë burime të shumta nga arkivat e Dubrovnikut, Venedikut, Romës, Milanos, Mantovës, Barcelonës etj., duke përfshirë edhe fragmente nga kronistët bizantinë, si Halkokondili, Dukasi, Sfrancesi dhe Kritobuli. Dokumentet për Skënderbeun nga arkivat e Barcelonës dhe të Milanos (gjithsej 105) janë dokumente, të cilat albanologu kroat Milan Shuflaj ia kishte huazuar Radoniqit. Në veprat e tij "Kurja Romake dhe vendet e sllavëve të jugut gjatë shek. XVI-XIX" (1950) dhe "Akte dhe diploma të Dubrovnikut", në disa vëllime, (1934-35) gjejmë të dhëna të shumta dhe të rëndësishme për Kosovën. (Gjon Berisha)

RADONIQI Zija (1954-). Pikturor. Lindi në Pejë. Shkollën fillore dhe Shkollën e Mesme të Artit i kreu në Pejë, u diplomua në Akademinë Mbretërore të Arteve të Bukura, drejtimi i pikturës, në Bruksel (1982). Në vitin 1980 u shpërblye me çmimin "Alexandre Alaux-Backes" të qytetit të Brukselit, ndërsa më 1981 mori çmimin e Lidhjes së Artistëve Profesionistë të Belgjikës. Nga viti 1983 punon në Shkollën e Artit në Pejë, si pedagog i vizatimit dhe i pikturës. Si anëtar i Shoqatës së Artistëve Figurativë të Kosovës mori pjesë në disa ekspozita kolektive brenda dhe jashtë vendit. Ekspozoi individualisht në Pejë (1987). Ishte kryetar i Shoqatës së Artistëve Figurativë për Rajonin e Pejës (1986-2000). Në pikturën e tij ndërthuret shprehja surreale dhe poentilike. (Rexhep Goçi)

RADOVIQ (Radović) Vladimir-Vlada (1901-1986). Pikturor. Lindi në Pejë. Kreu shkollimin fillor dhe të mesëm në Pejë, ndërsa Shkollën Shtetërore të Artit në vitin 1926 në Beograd. Ishte ndër themeluesit e Shkollës së Mesme të Artit në Pejë në vitin shkollor 1948/49, ku punoi deri në pension. Kreu edhe detyra të tjera në institucionet dhe sistemin arsimor të kohës. Në vitin 1955 themeloi Galerinë (mësonjëtorë-këshillimore) në Pejë. Veprimtaria e tij krijuese shquhet për teknikën e akuarelit dhe për motivet autoktone të vendlindjes. Opusin e veprave të tij e karakterizojnë portretet dhe imazhet e lojërave të Rugovës si dhe motivet shqiptare



VLADIMIR
RADOVIQ

nga Kruja deri në Sarandë. Hapi ekspozita në Pejë më 1926 dhe 1936, në Prishtinë më 1947, në Mitrovicë dhe sërish në Prishtinë më 1948, pastaj në Beograd 1952 dhe në qendra të tjera të ish-Jugosllavisë. Mori pjesë në shumë ekspozita të përbashkëta nga viti 1934, ndërsa në periudhën 1947-1975 ekspozoi pothuaj në të gjitha ekspozitat e Shoqatës së Artistëve Figurativë të Serbisë dhe të Kosovës. U nderua me çmime profesionale dhe mirënjohje publike. (Hivzi Muharremi)

RADUNOVIQ (Radunović) Velimir (1928-). Mjek, kirurg, profesor universiteti. Lindi në Nova Cërvenka, Mali i Zi. Mbaroi shkollimin fillor në vendlindje, kurse gjimnazin në Podgoricë. Kreu Fakultetin e Mjekësisë në Beograd (1953). Pas diplomimit u punësua në repartin e kirurgjisë të Spitalit të Përgjithshëm të Mitrovicës. Pas specializimit qëndroi për aftësim profesional në Paris dhe Moskë. Ishte anëtar i këshillit redaktues të "Acta chirurgica Iugoslavica" dhe kryeredaktor i parë i revistës së Shoqatës së Mjekëve të Kosovës "Praxis Medica". Më 1967 mori titullin primarius, më 1975 në Beograd mbrojti temën e doktoratës. Më 1971 u zgjodh docent i lëndës së kirurgjisë dhe kirurgjisë luftarake në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë, ndërsa titullin profesor ordinar e mori në vitin 1981. Në vitin 1977 kaloi me punë në Qendrën Klinike në Beograd. Është autor dhe bashkautor i shumë punimeve shkencore dhe profesionale. (Avdyl Krasniqi)

RAFINERIA E PLUMBIT, ZVEÇAN. E themeluar në vitin 1946, ishte organizatë punuese në përbërje të kombinatit "Trepca". Veprimtaria themelore e rafinerisë së plumbit ishte prodhimi i metaleve me ngjyrë, plumb dhe bismut, si dhe i metaleve fisnike, ar dhe argjend. Prodhimi i metaleve me ngjyrë dhe atyre fisnike zhvillohej në 12 kazanët 300 tonësh, si dhe në pajisjet e veçanta të furrave rrotulluese, flakore, kupeluese dhe të celulave të elektrolizës së arit dhe të argjendit. Lënda për rafinim ishte plumbi bruto nga shkriticorja, i cili kishte këtë përbajtje: metale me ngjyrë (Pb, Cu, As, Sb, Bi), ato fisnike (Au dhe Ag),

si dhe metale të rralla (Ge, Te, Ta). Ishte e domosdoshme që të bëhej rafinimi i plumbit për t'i larguar metalet shoqëruese, në mënyrë që të arrihej cilësia e dëshiruar me përbërje Pb-99,99%. Aftësia prodhuese e rafinerisë ishte 89,000 tonë në vit (1988). Për shkak të ndotjes enorme të ambientit, Administrata e OKB-së në Kosovë (UNMIK) pezulloi punën e metalurgjisë së plumbit. (Asllan Vitaku)

RAFUNA Naser (1980-). Aktor, producent. Lindi në Prishtinë, ku mbaroi shkollën fillore dhe të mesme. Kreu aktrimin në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës më 2003. Interpretoi një sërë rolesh në teatrot e Kosovës. Luajti në komedinë "Tre gjermanët e trashë" të Teatrit "Oda" në Prishtinë (2004), shfaqje që kishte shumë repriza. Është i njohur si aktor serialesh televizive dhe skeçesh humoristike, si "Kafeneja jonë", "Çka ka shpija" etj. Është themelues dhe drejtor shumëvjeçar i Festivalit ndërkombëtar të filmit të shkurtër "Shqip Film Fest". Ka interpretuar edhe në filma artistikë të metrazheve dhe zhanresh të ndryshme. (Besim Rexhaj)

RAHIMI Shukri (1925-). Historian, profesor universiteti. Lindi në Nasalcë të Bujanocit. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa normalen në Nish. Kreu Fakultetin Filozofik dega e historisë në Shkup më 1960. U doktorua në Fakultetin Filozofik të Prishtinës në janar të vitit 1974. Punoi profesor në Shkollën Normale të Shkupit dhe në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Shkup. Më 1974 kaloi në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës, si ligjërues i historisë së popujve të Jugosllavisë. Ka të botuara një numër punimesh shkencore dhe veprat "Vilajeti i Kosovës" (1974), "Lufta e shqiptarëve për autonomi 1897-1912" (1978). Në periudhën 1994-1998 ishte deputet i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë. (Zeqirja Idrizi)

RAHOVECI. Qytet në jugperëndim të Kosovës, qendër e komunës me të njëjtin emër. Pozita gjeografike e Rahovecit është shumë e përshtatshme, ngase gjendet në udhëkryqin që lidh Podrimen, Llapushën dhe Drenicën, ndërsa përmes Xërxës lidhet në rrugën kryesore Prizren-Pejë. Qyteti i Rahovecit ka sipërfaqe kadastrale prej 48.9 km² dhe rreth 15,892 banorë rezidentë. Rreth 20% e zonës kadastrale të këtij vendbanimi është e mbuluar me vreshta,



RAHOVECI

ndërsa pjesa tjetër përfshin arat dhe zonën e ndërtuar. Rahoveci është qytet i vjetër, me gjurmë të lashta që nga antika. Në këtë zonë janë gjetur disa eksponate të kësaj periudhe, të cilat dëshmojnë se banorët e këtij rajoni që në atë kohë merreshin me vreshtari. Në periudhën osmane janë ndërtuar disa objekte të karakterit fetar. Sipas defterit kadastral të sanxhakut të Shkodrës të vitit 1485, Rahoveci kishte 32 shtëpi, ndërsa në defterin e sanxhakut të Prizrenit të vitit 1591 ishin të regjistruara 43 shtëpi. Me emrin Rahovec është regjistruar edhe në një hartë austriake të vitit 1689. Në Rahovec janë ruajtur shumë shtëpi të vjetra karakteristike dhe objekte të tjera, siç është Kulla e Sahatit e ndërtuar në vitin 1784. Turizmi kulturor kryesisht bazohet në trashëgiminë kulturore-arkitektonike. Në qendër të qytetit janë të vendosura monumentet historike të ndërtuara rreth 400 vjet më parë: Teqja e Madhe-Helveti, Teqja Rufai, Teqja Melami, Kulla e Sahatit, pesë xhami, si dhe teqet e tjera në qytet. Pas Luftës së Dytë Botërore bëhen ndryshime të shumta në fizionominë e qytetit, duke u zvogëluar numri i popullsisë aktive në bujqësi, ndërsa mori krah zhvillimi i industrisë. Një ndër objektet më të rëndësishme industriale është ajo e masave plastike dhe bodrumi bashkëkohor i verës me kapacitet 200 vagonë. Rahoveci është qendër administrative, arsimore, shëndetësore, kulturore, sportive, tregtare për zonën e Podrimës. (Idriz Shala)

RAHOVECI (komuna). Komunë në pjesën jugperëndimore të Kosovës, me qendër qytetin me të njëjtin emër. Komuna e Rahovecit zë sipërfaqen prej 275.5 km², në të cilën jetojnë 56,208 banorë, në 36 vendbanime. Nga ana fiziko-gjeografike paraqiten tipare karakteristike që shprehen në shumëllojshmërinë

e peizazhit, me forma të ndryshme relievore. Zona perëndimore dhe jugore e komunës është kryesisht rrafshinore, me toka të përshtatshme për kultivimin e drithërave dhe perimeve, ndërsa pjesa veriore dhe lindore e komunës është kryesisht kodrinore, e mbuluar me vreshta dhe pyje. Ekzistojnë lidhje të mira rrugore me komunat e tjera përreth dhe më gjerë. Në jug të komunës kalon magjistralja dhe hekurudha Prizren-Pejë, ndërsa në një distancë rrugore prej 12 km Rahoveci lidhet me Rrugën e Kombit. Klima me tipare të mesme mesdhetare ndihet rreth lumit Drini i Bardhë, ku shtrihet një numër i tërë vendbanimesh, kurse ajo kontinentale vërehet në malet e Koznikut, Zatriqit dhe Shkozës. Temperaturat mesatare vjetore janë 11,7^o C. Maksimumi absolut paraqitet në muajin korrik prej 38,5^o C, ndërsa minimumi në muajin shkurt me -14,5^o C. Reshjet maksimale në Rahovec janë 1.047,2 mm, ndërsa minimale 609,9 mm. Mesatarja e reshjeve është 707.7 mm. Rrjeti hidrografik është relativisht i dendur. Kjo paraqet pasurinë natyrore të komunës dhe një ndër kushtet për ekzistencën e botës bimore dhe aktiviteteve njerëzore. Hidrografinë e territorit të komunës e përbëjnë disa qindra burime, lumenj dhe përrrenj, ndërsa nëpër të rrjedh edhe lumi Drini i Bardhë me gjatësi prej 30 km. Drini i Bardhë ka prerë masivin gëlqeror Gradishin, duke formuar grykën epigjenike atraktive me gjatësi prej 450 m. Në këtë kanion është ndërtuar Ura e Fshejtë me gjatësi prej 70 m dhe lartësi 30 m. Zhvillimi ekonomik në komunën e Rahovecit është orientuar më tepër në bujqësi, vreshtari dhe perimtari. Afro 65% e popullatës e sigurojnë ekzistencën nga aktivitetet bujqësore. Rahoveci paraqet bazën e prodhimtarisë së pemëve dhe perimeve në Kosovë. Në këtë trevë rrushi kultivohet qysh nga antika. Rreth 68% e territorit të komunës së Rahovecit është e mbuluar me toka bujqësore, ndërsa pjesa tjetër përfshin pyjet dhe zonat e ndërtuara. (Idriz Shala)

RAHOVECI sheh Sylejman (?-1771). Poet i letërsisë shqipe alhamiado, themelues i Teqesë së Madhe të halvetinjve në Rahovec. Rrjedh nga një familje e kamur, e cila mbante titullin Begzade. Paraardhësit e sheh Sylejmanit kanë jetuar në Elbasan, në Shkodër, në Brusë dhe në Potočan. Babai i tij Ejupi, nga Potoçani u vendos në Rahovec. Pas mbarimit të studimeve vijoi mësimet për misticizëm islam. Në vitin

1732 sheh Sylejmani ngriti teqenë dhe erdhi në postin e shehut, ku veproi derisa vdiq. Pasardhësit e tij kanë mbajtur postin e shehut në këtë teqe deri në ditët e sotme, por edhe poste të tjera fetare. Disa prej tyre kanë qenë edhe autorë veprash teologjike e letrare, si dhe skriptorë dorëshkrimesh. Dorëshkrimet e shumta të kopjuar nga pasardhësit e sheh Sylejman Rahovecit, të cilat i gjejmë edhe në teqe të tjera të Kosovës, dëshmojnë për një rol kulturor që ka luajtur Teqeja e Madhe e halvetinjve në Rahovec dhe themeluesi i saj, sheh Sylejmani. Ai është autor i ilahisë “Ah, un i mjeri kesh tue fjet”, e cila është ndër dëshmitë më të vjetra të letërsisë shqipe alhamiada në Kosovë. (Nehat Krasniqi)

RAHOVICA. Fshat në komunën e Preshevës, me mbi 1,000 shtëpi dhe me mbi 5,100 banorë (2002). Pas Tërrnocit është vendbanimi i dytë rural për nga madhësia në Luginën e Preshevës. Rahovica është fshat i banuar vetëm me popullsi shqiptare. Shtrihet në 465-500 m të lartësisë mbidetare, në të dy anët e lumit të Rahovicës, në kontaktin e shpateve të ulëta të Karadakut në perëndim me fushën e Preshevës në lindje. Shtrihet 2 kilometra në veri të Preshevës, në të dy anët e rrugës rajonale Miratoc-Lluçan. Afërsia gjeografike me Preshevën ka bërë që fshati me kalimin e kohës të bashkohet me të, ndërsa vazhdon të zgjerohet edhe në drejtim të veriut, në të dy anët e rrugës Preshevë-Raincë. Migrimet ditore të fuqisë punëtore dhe kontaktet më intensive të banorëve me qytetin kanë shpejtuar transformimin e strukturës sociale dhe ekonomike të popullsisë, ndërsa ngritja e disa objekteve të infrastrukturës shoqërore dhe publike, si: shkolla, stacioni shëndetësor, posta, ujësjellësi, kanalizimi dhe telefonia fikse etj., ka krijuar kushte për një jetë urbane, të ngjashme me atë në qytet. (Arsim Ejupi)

RAIÇEVIQ (Raičević) Vladimir (1948-). Inxhinier i makinerisë, profesor universiteti. Lindi në Bellolin të Prokuples, Serbi. Kreu studimet në Fakultetin Teknik të Universitetit të Prishtinës (UP). Kreu studimet pasuniversitare në Fakultetin e Makinerisë të Universitetit të Beogradit, ku mbrojti edhe tezën e doktoratës (1985). Në Fakultetin Teknik të UP-së ishte shef i seksionit të makinerisë dhe më pas shef i katedrës së mekanikës. Në vitin 1991, pas vendosjes së masave të dhunshme nga

administrata e Serbisë, emërohet dekan i Fakultetit të Makinerisë të UP-së. Ishte profesor i rregullt në Fakultetin Teknik të UP-së me seli në Mitrovicën e Veriut, pastaj dekan i këtij fakulteti dhe rektor i universitetit paralel. (Fehmi Krasniqi).

RAIFI Mensur (1938-2017). Shkrimtar, kritik letrar, profesor universiteti, përkthyes. Lindi në Vushtrri. Mbaroi shkollimin fillor dhe të mesëm në Mitrovicë, ndërsa u diplomua



MENSUR RAIFI

në Universitetin e Beogradit në gjuhë e letërsi frënge. Kreu studimet pasuniversitare më 1973 në Zagreb, ndërsa po aty, më 1977, mbrojti tezën e doktoratës “Rembo në Jugosllavi”. Një kohë ishte profesor i frëngjishtes në shkollat e mesme në Vushtri e Mitrovicë, disa vjet gazetar-recensent në rubrikën e kulturës të “Rilindja” (1968-1974). Ligjëroi letërsinë frënge në degën e gjuhës dhe të letërsisë frënge në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës, ku në vitin 1988 u zgjodh profesor ordinar. Krijimtarinë letrare e nisi me poezi, për t’iu përkushtuar përfundimisht studimeve dhe kritikës letrare, së pari në faqet e “Rilindjes” dhe më pas në revista e botime të veçanta. Botoi disa vëllime me kritikë letrare dhe studime për letërsinë. U mor dhe me përkthime (Bodler, Rembo, Verlen, Moren; Noli, Poradeci, etj.) Është themelues i Shoqatës së Përkthyesve Letrarë të Kosovës, ku realizoi botime të veçanta të letërsisë shqipe në gjuhë të tjera: frëngjisht, anglisht, gjermanisht, serbisht etj. Ka botuar këto libra: “Mbi poezinë bashkëkohore shqiptare” (1977), “Mbi prozën bashkëkohore shqiptare” (1978), “Fan Noli dhe Migjeni” (1979), “Polemika letrare” (1981), “Lasgushi, Noli, Migjeni” (1986), Tre poetë shqiptarë (1987, serbisht), “Fan Noli dhe çështja e Kosovës” (1995), “Mozaik letrar” (1998). Vdiq në Kanada. (Eqrem Basha)

RAINCA Ajjet (Ajjet Jahiu) (?-1946). Luftëtar kundër pushtuesve bullgarë dhe komandant i forcave vullnetare për mbrojtjen e kufirit lindor të Kosovës (1943-1944). Lindi në Raincë të Preshevës. Në kohën e Mbretërisë Jugosllave u dënua me burg, për shkak të kundërshtimit të pushtetit serb. Iu kundërvu me armë edhe

pushtuesve bullgarë më 1941. Në kuvendin e përfaqësuesve të forcave vullnetare të rajonit të Preshevës në tetor të vitit 1943 u zgjodh në shtabin e mbrojtjes. Pas kapitullimit të Bullgarisë në shtator 1944 u vu në dispozicion të forcave për mbrojtjen e kufirit. Në shtator të vitit 1944 u caktua komandant i njësiteve vullnetare shqiptare për mbrojtjen e kufirit nga forcat komuniste. U shqua sidomos në luftimet që u zhvilluan kundër njësiteve partizane serbe dhe bullgare në Rekë të Raincës. Pas mbarimit të luftës vazhdoi rezistencën. U vra në pabesi në fshatin e lindjes. (Ilir Zylfiu)

RAINCA. Fshat në Luginën e Preshevës, 12 kilometra në veri të Preshevës, shtrihet në lartësi mbidetare 440-460 m, në të dy anët e lumit të Raincës, në shpatet verilindore të Karadakut të Preshevës. Është vendbanim rural i tipit të dendur, që shtrihet në një sipërfaqe prej 1,405 ha. Në vitin 2002 fshati kishte 2,933 banorë rezidentë. Tokat pjellore në zgjerimin aluvial të lumit të Raincës kanë krijuar kushte për zhvillimin e bujqësisë, por ajo është ekstensive dhe me tendencë të rënies së vazhdueshme. Rrethanat ekonomike dhe situata jostabile politike kanë bërë që shumë të rinj të emigrojnë në botën e jashtme. Në aspektin e rëndësisë funksionale, Rainca është qendër e pavarur rurale, e cila zhvillohet larg ndikimeve funksionale të Preshevës, ndërsa popullsia e fshatit për plotësimin e shumë nevojave dhe shërbimeve orientohet në qytetin e Bujanocit. Prej objekteve të standardit shoqëror ka shkollën tetëvjeçare, stacionin shëndetësor, njësi tregtare dhe shërbyese etj. (Arsim Ejupi)

RAKA Adil (1946-). Mjek, stomatolog, specialist, profesor universiteti. Lindi në Kaçanik, shkollën fillore e kreu në vendlindje, gjimnazin në Prishtinë, kurse Fakultetin e Stomatologjisë në Zagreb (1972). Pas diplomimit u punësua stomatolog në Kaçanik. Më 1974 kaloi në Shtëpinë e Shëndetit në Prishtinë. Specializimin nga stomatologjia preventive dhe e fëmijëve e kreu në Fakultetin e Stomatologjisë në Zagreb, studimet pasuniversitare i mbaroi gjithashtu në Zagreb (1982), ndërsa tezën e disertacionit të doktoratës e mbrojti në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë (1988). Në vitin 1979 u zgjodh asistent i lëndëve pedodoncia dhe stomatologjia në Fakultetin e Mjekësisë në

Prishtinë, drejtimi i stomatologjisë, më pas docent, në vitin 1995 profesor inordinar dhe më 2005 profesor i rregullt. Nga viti 2000 deri 2006, për tre mandate ishte prodekan i Fakultetit të Mjekësisë. Kreu edhe detyra të tjera me përgjegjësi në kuadër të Fakultetit të Mjekësisë dhe të Ministrisë së Shëndetësisë të Kosovës. Ka publikuar një sërë punimesh shkencore dhe profesionale brenda dhe jashtë vendit. (Fatmir Dragidella)

RAKA Fadil (1944-2012). Gjuhëtar. Lindi në Kaçanik, ku kreu shkollën fillore. Shkollën e mesme dhe studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe i kreu në Prishtinë, ku kreu studimet pasuniversitare dhe mbrojti tezën e disertacionit të doktoratës (1985). Ishte drejtor i gjimnazit në Kaçanik dhe kryetar i kësaj komune. Ishte profesor i rregullt i Universitetit të Prishtinës, shef i degës së gjuhës shqipe dhe prodekan i Fakultetit të Filologjisë dhe anëtar i Këshillit Ndërkademiç të Gjuhës Shqipe. Mori pjesë në konferenca, duke publikuar një numër studimesh e artikujsh shkencorë nga fusha e dialektologjisë, e morfologjisë së shqipes dhe të historisë së standardizimit të shqipes. Ndër veprat kryesore të tij janë: “E folmja e Kaçanikut me rrethinë” (1984), “Historia e shqipes letrare” (1997) etj. (Agnesa Hasimja)

RAKA Lul (1969-) Mjek, mikrobiolog, mësimdhënës universitar. Lindi në Kaçanik. Kreu shkollimin fillor dhe të mesëm në vendlindje, ndërsa studimet në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë (1994). Pas diplomimit punoi si mësimdhënës në shkollën e mesme të mjekësisë “Elena Gjika” në Ferizaj dhe në Ambulancën humanitare “Nënë Tereza” në Kaçanik. Nga viti 1998 u përfshi në procesin mësimor në Fakultetin e Mjekësisë, si bashkëpunëtor profesional për lëndën e mikrobiologjisë mjekësore. Gjatë luftës ka qenë mjek në UÇK. U magjistrua në vitin 2002 në Prishtinë, ndërsa specializimin nga mikrobiologjia e mbaroi më 2004. Për aftësim specialistik qëndroi edhe në SHBA, Kanada, Holandë e Kroaci. Disertacionin e doktoratës e punoi në Universitetin e Zagrebit, ndërsa e mbrojti në Fakultetin e



LUL RAKA

Mjekësisë në Prishtinë (2009). U zgjodh profesor asistent i mikrobiologjisë në vitin 2010. Si bursist i Departamentit të Shtetit të SHBA-së qëndroi për përsosje profesionale në Karolinën Jugore dhe në Nju-Jork. (2002). Është autor dhe bashkautor i shumë punimeve shkencore të publikuara në një sërë vendesh të botës. Është bashkautor i disa teksteve ("Higjiena e duarve në kujdesin shëndetësor", "Mikrobiologjia e sepsës", "Mostrimi në mikrobiologjinë klinike" etj.), si dhe përkthyes i një sërë botimesh të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH). Është redaktor dhe recensent në një sërë revistash shkencore ndërkombëtare. Nga OBSH-ja ishte i dërguar si këshilltar në ekipin e ekspertëve në përballje me epideminë e ebolës në Liberi gjatë vitit 2014. (Gjyle Mulliqi)

RAKA Lumnije (1976-1999). Luftëtare e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), dëshmore. Lindi në Kaçanik. Kreu shkollën e mesme në Prishtinë dhe i vazhdoi studimet për pedagogji në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Në tetor të vitit 1998 iu bashkua njësiteve të UÇK-së. Si infermiere ndihmoi me medikamente dhe në shërimin e të plagosurve. Pas stërvitjeve përkatëse u caktua në njësitin e policisë ushtarake që vepronte në qytetin e Kaçanikut. Mori pjesë në shumë aksione dhe beteja kundër forcave serbe. Nga muaji mars 1999 punoi si infermiere e luftës në kuadër të skuadrës vëzhguese dhe të policisë ushtarake të Brigadës 162 "Agim Bajrami". Në qytetin e Kaçanikut, më 8 prill ushtria serbe ndërmori një sulm të gjerë mbi popullatën civile. Më 9 prill 1999, në mbrojtje të qytetarëve të plagosur ra edhe L. Raka së bashku me 28 bashkëluftëtarë. (Hajrush Kurti)

RAKA Tefik (1939-1999). Veprimtar, historian, dëshmor. Lindi në Kaçanik. Kreu Shkollën Normale në Prishtinë, ndërsa studimet për histori në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës, ku më pas kreu edhe studimet pasuniversitare (1977). Gjatë viteve 1981-1983 ishte kryetar i komunës së Kaçanikut, ndërsa më pas këshilltar arsimor në Entin Pedagogjik në Ferizaj dhe inspektor komunal i arsimit në Kaçanik. Ishte njëri ndër themeluesit e Shoqatës së Historianëve të Kosovës "Ali Hadri". Më 10 gusht 1998 u arrestua nga policia serbe dhe u dënua me 3 vjet burg, me akuzën se është pjesëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Më 22 maj 1999 forcat ushtarake serbe e ekzekutuan në burgun e Dubravës. Botoi disa libra dhe një sërë punimesh shkencore nga fusha e historisë, ndër të cilët: "Kaçaniku me rrethinë 1912-1918, masakrat, internimet, qëndresa". (Hajrush Kurti)

RAKOSHI. Fshat në komunën e Istogut, 12 km në lindje të tij. Shtrihet në lartësi mbidetare 500 m dhe sipërfaqe 495,8 ha, nga e cila pjesën dërrmuese (80%) e zënë arat. Është vendbanim i tipit të shpërndarë me këto lagje: Haxhijaj, Balaj, Muhaxhir, Shalë, Tafilaj dhe Hajrizaj. Si vendbanim përmendet në disa dokumente mesjetare, si atë të Manastirit të Stonit të Dubrovnikut (1253), defterin e sanxhakut të Shkodrës (1485) etj. Në vitin 2011 janë regjistruar 872 banorë, ndaj 535 banorëve në vitin 1948. Popullsia merret kryesisht me bujqësi, blegtori, tregti etj. Nga objektet e standardit shoqëror ka shkollën 9-vjeçare, stacionin shëndetësor etj. (Ferim Gashi)

RAKOVICA Enver (1949-). Grafist. Lindi në Prishtinë. Kreu Shkollën e Mesme të Grafikës në Beograd, ndërsa Shkollën e Lartë Grafike në Zagreb (1973). Mbaroi Akademinë e Arteve në Prishtinë, degën e dizajnit grafik (1988), ndërsa studimet pasuniversitare i kreu në Stamboll (1991). Një kohë të gjatë punoi në shtypshkronjën "Rilindja", ndërsa pas luftës në administratën komunale të Prishtinës dhe ishte mësimdhënës i grafikës dhe i dizajnit në kolegje private. Shquhet për mjeshtërinë e teknikës së sito-shtypit në grafikën e formatit të madh me kompozicione abstrakte. Me po atë ndjeshmëri kultivon dhe akuatintën në formate të vogla, por të detajuara mirë. Organizoi disa ekspozita personale, si: në Prishtinë (1995), në Stamboll (1996), në Prizren (Galeria "Rada", 1996), si dhe në Rotterham, Huddersfield dhe Harrogate të Britanisë së Madhe. Në vitin 2004 iu prezentua publikut të Prishtinës me ekspozitë në Galerinë e Ministrisë së Kulturës. Mori pjesë edhe në ekspozita të përbashkëta në Kosovë, Turqi, Spanjë, Japoni, Norvegji, Britani të Madhe, SHBA etj. (Fatmir Krypa)

RAKOVICA Hysen (1938-2007). Mësimdhënës në Fakultetin e Kulturës Fizike dhe të Sportit. Lindi në Prishtinë, ku kreu shkollën fillore dhe të mesme. Fakultetin e e Kulturës Fizike e përfundoi në Nish, ndërsa studimet

pasuniversitare në Zagreb. Disertacionin e doktoratës e mbrojti në vitin 1997, në Fakultetin e Kulturës Fizike në Prishtinë dhe u zgjodh ligjërues për lëndën e atletikës. Për shumë vjet ishte bashkëpunëtor profesional i Federatës së atletikës së Kosovës. Në periudhën 1991-1999 u bashkua me nismëtarët për pavarësimin e sportit të Kosovës. Një kohë ishte edhe trajner i klubit të basketbollit “Kosova” të Obiliqit, në konkurrencën e meshkujve, që bënte gara në ligën e parë të Kosovës. (Edmond Thaçi)

RAMA Agron (1972-1999). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Hero i Kosovës. Lindi në Smolicë të Gjakovës. Në vitet '90 emigroi në Zvicër. Më 1997 u kthye në vendlindje dhe u përfshi në radhët e UÇK-së. Nga prilli dhe deri në gusht të vitit 1998 luftoi në Smolicë dhe pastaj në Popoc, Ponošec, Morinë, Dobrosh etj. Më pas u shqua edhe në luftimet në Ratish, Glogjan e Dashinoc. Me themelimin e Brigadës 134 “Bedri Shala” të UÇK-së të Zonës Operative të Dukagjinit, A.Rama u emërua komandant i kësaj brigade. Në një aksion në Smolicë, më 16 dhjetor 1998 u plagos rëndë. Trajtimi mjekësor iu bë në spitalin ushtarak të UÇK-së në Zhebel dhe më pas u dërgua për shërim në Shqipëri. Në rrugë e sipër e mbijetoi pritën tek Ura e Terzive në Bishtazhin, që iu bë më 27 janar 1999. Të nesërmen, në malet e Godenit, u ndesh në pritën e dytë, ku mori edhe katër plagë të tjera. Në mbrëmjen e 29 janarit, në Rogovë të Hasit A. Rama ndërroi jetë në ditën kur në këtë fshat u vranë nga forcat serbe 16 ushtarë të UÇK-së dhe civilë të fshatit. Në vitin 2012 presidentja e Kosovës ia ndau Urdhrin “Hero i Kosovës”. (Faton Mehmetaj)

RAMA Favzi (1957-1986). Futbollist. Lindi në Podujevë. Nisi të luante futboll që në fëmijëri të hershme. Shumë shpejt arriti të bëhej një mesfushor i pazëvendësueshëm, fillimisht te “Llapi” i Podjevës, ndërsa më vonë te “Prishtina”. Në “Prishtinë” ishte i pakalueshëm në rolin e qendërmbrojtësit. Luajti plot pesë vjet pa ndërprerje në përbërjen e parë të “Prishtinës”, e cila në ato vite bënte pjesë në elitën e atëhershëm të futbollit të Jugosllavisë. Ka luajtur edhe për “Vëllazninim” e Gjakovës, ndërsa një vit luajti edhe jashtë Kosovës, duke u bërë anëtar i skuadrës së Ligës së parë të Turqisë “Eskisehirspor” (1986). Humbi jetën

tragjikisht në një aksident trafiku. (Besim Kajtazi)

RAMA Ismail (1942-). Aktor, skenograf, kostumograf. Lindi në Sojevë të Ferizajt. Studimet për aktrim dhe art figurativ mbaroi në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prishtinë. Gjatë viteve 1971-1988 ishte anëtar i trupës profesioniste të Teatrit të Kombësive në Shkup. Luajti në një sërë rolesh dhe realizoi disa shfaqje teatrore si regjisor, skenograf dhe kostumograf. Rolet më të arrira i realizoi në shfaqjet: “Zbutësi i njerëzve me sy zymryti”, “Fundrrinat”, “Nita”, “Karnavalet e Korçës”, “Mbreti Edip”, “Antigona”, “Unë Halil Garria”, “Krushqit janë të ngrirë” etj. Për rolin kryesor në shfaqjen “Pamja nga ura” në regji të S. B. Krasniqit u shpërblye me çmimin për rolin protagonist në Festivalin e Teatrove të Maqedonisë në Prilep (1977). Kreacione të suksesshme realizoi edhe në shfaqjet “Raspuçini” dhe “Plagët e Gjergjezit”, e cila ishte shfaqja e fundit që realizoi në Teatrin “Adriana Abdullahu” në Ferizaj (2009). Pos në teatër, I. Rama luajti edhe në filmat: “Era dhe lisi”, “Kur pranvera vonohet”, “Kalorësit e stuhishëm”, “Rojet e mjegullës”, “Desha ta shoh diellin”, “I zhdukuri”, “Martesa e artë” dhe në filmat televizivë “Ibe Palikuqi”, “Rropullari”, “Jeta e një toke” etj. Realizoi edhe disa shfaqje si regjisor, bëri skenografi dhe kostumografi në disa syresh. Për kostumet e shfaqjes “Zbutësi i njerëzve me sy zymryti” në regji të A. Jakupit mori çmimin për kostumografi në Festivalin e Teatrove në Prilep të Maqedonisë (1981). (Fadil Hysaj)

RAMA Kadrush (1938-2004). Piktur. Lindi në Barainë të Podujevës. Kreu shkollimin në Podujevë dhe në Pejë. Fakultetin e Arteve dhe studimet pasuniversitare i kreu në Zagreb. Në fillim punoi në Shkollën Normale në Prishtinë, pastaj disa vjet ishte profesor në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prishtinë. Më vonë u zgjodh mësimdhënës i metodikës në Fakultetin e Arteve në Prishtinë. Pas disa vjetësh u emërua mësimdhënës i aktit të mbrëmjes po në këtë fakultet, ku punoi deri në pensionim. I takon gjeneratës së krijuesve figurativë që me përkushtim e avancuan artin pamor në Kosovë. Motivet e pikturave të tij janë të ndryshme, si natyra e qetë, portreti, por edhe peizazhi. Kultivoi një kolorit specifik. Suksesin më të madh e arriti me ciklin “Simfonia e bardhë

në sfondin e bardhë”. Përveç në ekspozita të shumta në vend, vepra e tij u ekspozua edhe në Zagreb, Shkup, Paris, Ankara, Tiranë, Nju-Jork etj. Për punë krijuese u nderua me disa çmime dhe mirënjohje. Në vitin 1982 mori çmimin e Sallonit Pranveror, ndërsa më 2003 çmimin e Sallonit XXXI në Prishtinë. (Bislim Aliu)

RAMA Milaim (1976-). Ish-futbollist. Lindi në Viti. Karrierën si profesionist e nisi në vitin 1997 te skuadra zvicerane “Thun”. Në këtë kohë mori ftesë nga përfaqësuesja e Zvicrës (2003) dhe ishte pjesëmarrës në “Euro 2004”, duke u bërë shqiptari i parë që mori pjesë në këtë turne. Për Zvicrën regjistroi shtatë paraqitje, kurse në verën e vitit 2004 kaloi në Gjermani, te skuadra e “Augsburgut”, ku qëndroi vetëm një edicion. U kthye në Zvicër dhe luajti për skuadrën e “Shaffhausen-it” (2005/06). Në vitin 2006 u kthye te skuadra ku e nisi karrierën dhe e ndihmoi që të kualifikohet edhe në Ligën e Europës. Luajti për “Thunin” deri në vitin 2012, ku i dha fund karrirës aktive. (Tahir Sopi)

RAMA Përparim (1976-). Arkitekt, artist konceptual. Lindi në Prishtinë, u shkollua në Prishtinë dhe Londër. Studimet i kreu në “London South Bank University” të Londrës (2003). Punoi në Londër dhe Nju-Jork dhe më pas themeloi studion “4M Group” (2004) për projektim arkitektonik në Londër dhe Prishtinë. Projektion rezidenca dhe hotele luksoze, komplekse mikse, si dhe planifikim urban. “4M Group” u vlerësua nga “Open City” ndër pesëdhjetë studiot projektuese të qëndrueshme në Mbretërinë e Bashkuar (2009). Udhëhoqi konzorciumin ndërkombëtar në projektin ideor të kompleksit të përzier në Prishtinë, planin rregullues urban “Prishtina Qendra 1”, masterplanin e fshatit të qëndrueshëm bregdetar në Dhërmi, Shqipëri. Veprimtarinë e tij e shtriu edhe në Nju-Jork, Dublin, Udine, Kotor, Lagos, Bazel, Pragë, Xhakartë etj. Mori pjesë në Bienalen XIII të Arkitekturës në Venecia me një instilacion të vlerësuar si “demokraci arkitekturale” Ka fituar një sërë çmimesh në konkurse dhe prezantime të ndryshme. Jeton në Londër. (Flamur Doli).

RAMA Rafet (1971-). Veprimtar politik, luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), deputet. Lindi në Prekaz të Skënderajt. Që nga shpërthimi i luftës në Kosovë u

bashkua radhëve të UÇK-së. Ballafaqimin e parë ushtarak me forcat serbe e kishte në afërsi të kufirit Kosovë-Shqipëri, në maj të vitit 1997. Gjatë luftës çlirimtare ishte komandant batalioni në Brigadën 114 “Fehmi Lladrovci” të UÇK-së. Pas luftës studioi për menaxhim dhe biznes në Prishtinë. Gjithashtu vijoi shumë trajnime specializimi. Ishte këshilltar për siguri në Ministrinë e Rendit, zyrtar për trajnime në Trupat e Mbrojtjes së Kosovës dhe këshilltar në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Në qershor të vitit 2014 u zgjodh deputet i Kuvendit të Kosovës. (Sylë Ukshini)

RAMA Rrahman (1970-). Njëri nga themeluesit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), komandant i Zonës Operative të Shalës. Lindi në fshatin Akrashticë të komunës së Vushtrrisë.



RAHMAN RAMA

Qysh në moshë të re u përfshi në aktivitete për çështjen kombëtare. Kontaktet e para me UÇK-në i mori në Prekaz të Drenicës që nga viti 1993. Ishte njëri ndër themeluesit e UÇK-së që nga formimi i celulave të para të saj. Formoi dhe komandoi me sukses Zonën Operative të Shalës. Ishte pjesëmarrës dhe udhëheqës i disa udhëtimeve ilegale për në Shqipëri, për sigurimin e armatimit. Mori pjesë në betejat që u zhvilluan në Kaçandoll, Rahovë, Ashlan etj. Pas luftës mbajti poste me rëndësi në Trupat Mbrojtëse të Kosovës (TMK), përfshirë edhe atë të zëvendëskomandantit të TMK-së (2006-2009). Më pas ishte komandantit i Komandës së Forcave Tokësore dhe zëvendëskomandant i Forcës së Sigurisë së Kosovës (2009-2015). Nga maji i vitit 2015 mori detyrën e komandantit të Forcës së Sigurisë së Kosovës. (Miftar Kurti)

RAMA Sadik (1872-1944). Veprimtar i lëvizjes për çlirim dhe bashkim kombëtar. Lindi në fshatin Gjurjevik të Klinës. Në moshë të re mori pjesë dhe u dallua për trimëri në luftë kundër pushtuesve osmanë në Drenicë (1893). Ishte pjesëmarrës në lëvizjet popullore kundërosmane të viteve 1909-1910 dhe njëri nga udhëheqësit e kryengritjes së përgjithshme kundërosmane (1912). Mori pjesë në Kuvendin e Junikut dhe në luftërat kundër pushtuesve serbo-malazezë e austro-bullgarë

në vitet 1913-1923. Në vitet 1919-1923 drejtoi çetat kryengritëse të zonës së Podrimës dhe Prekorupës. I ngarkuar nga Komiteti “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës” në pranverën e vitit 1919, mori pjesë në organizimin dhe drejtimin e kryengritjes në Rrafsh të Dukagjinit e Drenicës kundër Serbisë. Gjatë qëndrimit të shkurtër në Shqipëri, u takua me Hasan Prishtinën dhe me disa krerë të Lëvizjes. Më 1921-1923 mbrojti Zonën Neutrale të Junikut. Në shkurt të vitit 1923 u vendos me familje në Qerret të Kavajës. Më 1924 mbështeti ardhjen e Fan Nolit në pushtet. Në prill 1939 priti me armë pushtuesit italianë. Më 1941, pas bashkimit të Kosovës me Shqipërinë, u kthye në Kosovë. Vdiq në Rahovec. (Lush Culaj)

RAMA Sali (1892-1963). Luftëtar i lëvizjes për pavarësi dhe bashkim kombëtar. Me origjinë nga Boga e Rugovës, lindi në Traboiq të Pejës. Udhëhoqi luftën për mbrojtjen e kufirit nga Mali i Zi. Më 1912, bashkë me shumë rugovas merr pjesë në luftën e Beranës dhe më pas në betejën e parë të Moknës. Më 1919 kundërshton çarmatimin e rugovasve nga pushtuesi serb. Po këtë vit udhëheq rezistencën, për të mos lejuar ushtrinë serbe ta nënshtrojë Rugovën. Po këtë vit kalon në Shqipëri, përmes Junikut. Më 1921 Sali Rama dhe Ker Sadria kishin në radhët e veta më shumë se 100 luftëtarë të rregullt dhe më 1924 u vunë në mbështetje të qeverisë së Nolit. Në vitin 1941 komandoi vullnetarët në mbrojtje të kufirit me Malin e Zi. Në vitin 1942 mori pjesë në Luftën e Pazarit të Ri, në cilësinë e anëtarit të shtabit ushtarak. Po atë vit mori pjesë në betejat e Shekullarit, Kalludrës, Murgash Smilovicës dhe Moknës. Ishte delegat në Kuvendit Themelues të Lidhjes së Dytë të Prizrenit (1943). Më 1947 dënohet me vdekje. Dënimi iu kthye në 20 vjet burg. Vdiq në Treboviq të Pejës. (Lush Culaj)

RAMA Suad (1983-) Piktore. Lindi në Prishtinë. Kreu arsimin fillor dhe të mesëm në vendlindje, studimet për pikturë në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. Hapi disa ekspozita personale: “Hani i 2 Robertëve” (Prishtinë, 2008), Galeria “Expoart 40” (Prishtinë, 2010), Galeria e Ministrisë së Kulturës (Prishtinë, 2012,), galeria e qytetit Racibor, Poloni etj. Mori pjesë në disa ekspozita kolektive brenda dhe jashtë vendit. Është fitues i katër çmimeve. Në Fakultetin e Arteve është angazhuar si ligjërues

i jashtëm. Në pikturat e tij trajton trupin njerëzor, duke u orientuar nga e brendshmeja e njeriut. Legjendat, veçmas ajo e Rozafës, janë preokupim tematik i disa veprave të tij. (Ilir Muharremi)

RAMABAJA Muharrem (1956-). Gazetar. Lindi në Magurë të Kamenicës. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Hogosht dhe Kamenicë, ndërsa studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe i përfundoi në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Nga viti 1977 punoi në revistën “Zëri i rinisë”, si gazetar, pastaj reporter i lirë, redaktor dhe në vitet 1990-1993 ishte drejtor i kësaj ndërmarrjeje gazetare e botuese po me këtë emër. Merret edhe me shkrime letrare. Nga viti 1993 jeton në Gjermani. (Bajrush Morina)

RAMABAJA Rushit (1948-). Shkrimtar. Lindi në fshatin Marec të Prishtinës. Një kohë të gjatë punoi në të përditshmen “Rilindja”, në fillim gazetar e më vonë redaktor i rubrikës së kulturës. Më pas ishte redaktor në të përditshmen “Lajm”. Në vitet e fundit u angazhua në emisione të Radio Kosovës. Është njëri nga prozatorët më produktivë në letërsinë bashkëkohore në Kosovë, autor i një sërë romanesh dhe përmbledhjesh me tregime. Shkroi edhe drama, që u inskenuan në teatrot shqiptare. Kontribuoi edhe në publicistikë, duke qenë kolumnist e opinionist në mediet e shkruara kosovare. Ka botuar këto vepra: “Kangjella e Domastionit” (roman, 2009), “Një gomar për parlament” (tregime, 2008), “Shtëpia ku nuk vdiset: rekuem për Xheladin Hanën” (monografi, 2003), “Fajnitë e apostujve” (roman, 2002), “Rrëmbimi i vajzës së këngës” (tregime, 2001), “Baladë për vendlindjen” (tregime, 1991), “Të dielën erdhi Rozafa” (roman, 1990), “Gjergj Elez Alia” (novelë, 1983), “Grigja” (roman, 1982), “Çupërlina” (roman për fëmijë, 1976), “Shqiponjat e agimit” (poezi, 1971), “Kryezoti i fermës së qenve” (novela, 2011) etj.. Është autor i tekstit “Cubi i Kukurrecit”, i realizuar në skenë nga Teatri Kombëtar si dhe i librit “Mareci i Shpresës së mirë”. (Adil Olluri)

RAMABAJA Sadri (1961-). Gazetar. Lindi në Magurë të Gollakut, Kamenicë. Shkollën fillore dhe atë të mesme i kreu në Kamenicë, ndërsa studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe i

kreu në Tiranë, ku edhe doktoroi në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare. Në periudhën 1982-1990 ishte veprimtar i Lëvizjes Popullore për Republikën e Kosovës. Më 1983 u arrestua dhe u dënua me tri vjet burg. Më pas largohet në Zvicër dhe në vitet 1987-1990 ishte redaktor në gazetën “Zëri i Kosovës”, ndërsa gjatë viteve 2001-2004 bashkëpunëtor profesional për Medie në Institutin Ost-West në Bernë. Nga fillimi i viteve ‘90 ishte bashkëpunëtor i disa gazetave shqiptare: korrespondent i gazetës “Fakti”, më pas (2006-2008) redaktor dhe kryeredaktor i të përditshmes “Lajm” në Prishtinë. Është autor i dy librave publicistikë “Realizmi politik dhe çështja kombëtare” (1998) dhe “UE-ja shpresë apo ringjallje utopish” (2003) dhe i librit me poezi “Feniksit ia gjeta çerdhen” (1993). (Artan Krasniqi)

RAMADANI Agim (1963-1999). Veprimtar politik, ushtarak, Hero i Kosovës. Lindi në fshatin Zhegër të komunës së Gjilanit. Mbaroi studimet në Akademinë Ushtarake në Zagreb.



AGIM RAMADANI

U mor me poezi dhe pikturë që nga shkolla e mesme. Hapi ekspozita personale dhe të përbashkëta në Kroaci dhe në Zvicër. Me fillimin e luftës në Kroaci, braktisi ushtrinë jugosllave dhe më 1990, së bashku me familjen, emigroi në Zvicër. Aty vazhdoi veprimtarinë patriotike, kulturore dhe artistike. U zgjodh drejtor i Qendrës Kulturore për Diasporë e Mërgatë në Cyrih të Zvicrës. U kthye në Kosovë në qershor të vitit 1998 dhe u vendos në Zonën Operative të Dukagjinit. Më 9 gusht dhe 15 shtator 1998 mori pjesë në aksione ushtarake të UÇK-së, të zhvilluara në Oplazë dhe në bjeshkën e Gjeravicës, ku armikut iu shkaktua humbje të mëdha. Në periudhën e armëpushimit midis UÇK-së dhe forcave jugosllave, gjatë muajve tetor-dhjetor 1998, shkoi sërish në Zvicër, me qëllim të mobilizimit të të rinjve në radhët e UÇK-së. Më 9 prill të vitit 1999, një njësit i Brigadës 138 të Zonës Operative të Dukagjinit, i udhëhequr nga Agim Ramadani, në luftime të drejtpërdrejta me forcat ushtarake dhe paramilitare serbe arriti të zmbrajs pikat ushtarake serbe në zonën e Koshares të brezit kufitar ndërmjet Jugosllavisë dhe Shqipërisë. Më 11

prill 1999, derisa ishte në realizimin e detyrave ushtarake, ra heroikisht në luftime të drejtpërdrejta te vendi i quajtur Rrasa e Zogut. Pas rënies, Brigada 138 mori emrin e tij. Në vitin 2005 u nderua me Urdhrin “Hero i Kosovës”, ndërsa në vitin 2015 në Shqipëri iu akordua dekorata “Nderi i Kombit”. (Bedri Muhadri)

RAMADANI Arben (1981-2000). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) dhe i Ushtrisë Çlirimtare për Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë (UÇPMB), dëshmor. Lindi në fshatin Kokaj të komunës së Gjilanit. Në fund të majit të vitit 1999, ende pa i mbushur 18 vjet, u bashkohet radhëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Pas përfundimit të luftës së Kosovës u angazhua në organizimet e para të Ushtrisë Çlirimtare për Preshevë, Medvegjë e Bujanoc (UÇPMB) me detyra logjistike. Veprroi në kuadër të Brigadës 113 “Ibrahim Fejzullahu”. Shtabi i Përgjithshëm i UÇPMB-së e ngarkoi me detyrën e transportimit të armëve në drejtim të Preshevës, që e kreu me sukses. Derisa po kalonte kufirin me Kosovën bashkë me njësitin e tij, ra në pritë dhe u vra nga forcat serbe më 19 maj 2000, në vendin e quajtur Gare të komunës së Preshevës. Më 2011 u rivarros në Varrezat e Dëshmorëve në Gjilan. (Fehari Ramadani)

RAMADANI Bashkim (1947-). Gazetar. Lindi në fshatin Jezerc të komunës së Ferizajt. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, Shkollën e Lartë Pedagogjike në Gjakovë. Më pas kreu studimet për histori në Fakultetin Filozofik të Prishtinës. Një kohë punoi mësimdhënës dhe drejtor shkollë në Jezerc, ndërsa më 1974 filloi punën në Televizionin e Prishtinës (RTP), në fillim gazetar dhe më pas redaktor në programin informativ-politik. Në vitin 1990 largohet nga RTP-ja nga masat e dhunshme serbe, bashkë me punëtorët e tjerë. Në vitin shkollor 1995/96 punoi këshilltar pedagogjik në Entin Rajonal të Prishtinës për Përparimin e Shkollave. Pas luftës ishte kryeredaktor në agjencinë e “Media Action Internacional” me seli në Gjenevë (2002-2012). Nga viti 2009 deri në pensionim (2012) punoi bashkëpunëtor profesional në Arkivin e Radiotelevizionit të Kosovës. (Shefqet Rexhepi)

RAMADANI Bekim (1970-). Mësimdhënës i muzikës, publicist. Lindi dhe u shkollua në Tetovë. U diplomua në Fakultetin e Arteve

të Tetovës, dega teoriko-pedagogjike, ndërsa studimet pasuniversitare i kreu në Universitetin e Arteve në Tiranë (2006). Punoi në gjimnazin e Shkupit (2002-2004), në gjimnazin e Tetovës (2004-2015) dhe nga viti 2012 është i angazhuar në Universitetin e Tetovës. Gjatë viteve 2006-2014 botoi punime profesionale-shkencore në mediet e shkruara. Botoi: “Këngë të zgjedhura korale” (2010), “Kush këndon keq, s’mendon” (2011), “Asgjë nga balta e fjalëve” (2011), “Fjalë pa këngë” (2013), “Nga kënga në këngë” (2013), “Dëgjo këngën e harro brengën” (2015). Përktheu tekste mësimore për metodikën e mësimin të muzikës (2014). Dirigjoi korin e vajzave (2011-2014), mori pjesë në disa festivale në Maqedoni dhe disa herë fitoi vendet e para. (Indira Çipa)

RAMADANI Ibrahim (1959-). Gjeograf-planer, profesor universiteti. Lindi në Muhoc, komuna e Bujanocit. Shkollën fillore e mbaroi në vendlindje, gjimnazin në Bujanoc, ndërsa diplomoi në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore (FSHMN) në Prishtinë (dega e gjeografisë) në vitin 1982. Studimet pasuniversitare i kreu në Fakultetin e Arkitekturës të Universitetit të Sarajevës, ku magjistroi



IBRAHIM
RAMADANI

në vitin 1989 dhe fitoi titullin magjistër i shkencave urbanistike. Në vitin 1996 u zgjodh ligjërues në departamentin e gjeografisë të FSHMN-së në Universitetin e Prishtinës, në vitin 2002 doktoroi në fushën e planifikimit dhe të urbanizmit dhe në vitet vijuese punoi po në këtë departament, duke ushtruar për disa vjet edhe detyrën e shefit të departamentit të gjeografisë. Është autor dhe bashkautor i teksteve dhe monografive: “Zhvillimi rural” (2004), “Mjedisi jetësor” (2011), “Baraspesha e trazuar” (2012), “Menaxhimi i resurseve natyrore” (2013), “Planifikimi hapësinor dhe urban” (2013), “Vendbanimet e Kosovës” (2016) etj. Ka publikuar një numër punimesh shkencore në revista të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare nga lëmi i planifikimit, urbanizmit dhe mjedisit. Gjithashtu ka udhëhequr disa projekte lidhur me planet zhvillimore komunale dhe urbane për disa qytete të Kosovës. (Arsim Ejupi)

RAMADANI Musa (1944-). Shkrimtar, eseist, dramaturg, kritik teatri dhe gazetar. Lindi në Gjilan. Shkollimin fillor e kreu në Prizren, Gjilan dhe Viti. Më pas në Gjilan kreu shkollimin e mesëm, ndërsa në Prizren mbaroi Shkollën e Lartë Pedagogjike. Nga viti 1965 punoi si gazetar, recensent teatror dhe redaktor i rubrikës së kulturës në gazetën “Rilindja”. Shkrimet e para letrare i botoi te revista “Jeta e re” dhe te javorja “Zëri i rinisë”. Dorëshkrimin “Neurosis” të refuzuar nga “Rilindja” e botoi vetë në vitin 1973. Libri u vlerësua avangardist dhe prijës i poetikës voko-vizuale dhe sinjalistike në letërsinë e Kosovës. Gjatë viteve ‘70 në Festivalin e Akordeve të Kosovës për kompozime të muzikës së lehtë, fitoi dy herë çmimet e para. Botoi këto vepra poetike: “Mëkatet e Adamit” (1969), “Thirravaje” (1971), “Neurosis” (1973), “Muzat nuk flenë” (1976), “Alfabeti i neurozave” (1982), “Eugjenika e tri deteve” (1986), “Nostalgjia antike” (1990) dhe “Mëkatet e E(ha)vës” (2010). Proza e tij është letërsi e erudicionit të thellë me elemente të theksuara moderne dhe postmoderne. Veprat e tij në prozë janë: “Romani pa kornizë” (1975); “Fluroma”, tregime (1978); “Zezona”, roman (1978); “Ligatina”, roman (1983); “Satana ma vodhi gurin e urtisë”, tregime (1987); “Vrapuesja e Prizrenit”, roman (1995); “Antiprocioni”, roman (1997); “Inamor: 55”, minitregime (2000). Më 1984 botoi dramën “Moisiu në Unazën e Inlandit”, e cila u inskenua në Tetarin e Gjakovës dhe në Teatrin Kombëtar të Kosovës. M. Ramadanani me shkrimet kritike dhe eseistike për teatrin dhe shfaqjet teatrale dha kontribut për ngritjen e cilësisë artistike të dramaturgjisë dhe të teatrit në Kosovë. Nga fusha e kritikës teatrore, botoi librat: “Fjala në skenë” (1980) dhe “Premiera shqiptare” (1994). Si përkthyes solli në shqip disa autorë të letërsisë botërore, si: Dino Bucati, Sadek Hedajat, Per Lagerkvist, Jashar Kemal, Jezhi Andzhejovski etj. Poezia e tij u prezantua në disa antologji dhe u përkthye në gjuhë të ndryshme. Është laureat i çmimit “Hivzi Sylejmani” (1987), i çmimit të Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës (2000), i çmimit “Beqir Musliu” (2006) dhe i Çmimit Kombëtar për Vepër Jetësore “Azem Shkreli” (2013). (Agron Gashi)



MUSA RAMADANI

RAMADANI Nysret (1935-). Mjek, fiziolog, pediatër, profesor universitar. Lindi në Lubizhdë të Prizrenit, shkollën fillore e kreu në vendlindje, gjimnazin në Prizren. U regjistrua në Fakultetin e Mjekësisë në Zagreb, por më vonë studimet i vazhdoi në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Rijekës, në Kroaci (1962). U punësua në Shtëpinë e Shëndetit në Prizren dhe u transferua në Zym të Hasit. Specializimin nga lëmi i pediatriisë e përfundoi në Fakultetin e Mjekësisë në Zagreb, punoi si pediatër në Prizren dhe, me hapjen e Fakultetit të Mjekësisë u zgjodh asistent i lëndës fiziologjia e njeriut (1970). Mbrojti tezën e disertacionit të doktoratës po në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë më 1976. Pas doktoratës u avancua në titujt përkatës universitarë, duke arritur edhe titullin e profesorit ordinar. Ishte fiziologu i parë shqiptar në Kosovë. Një mandat ishte deputet i Kuvendit të Kosovës (1968) dhe u angazhua për hapjen e Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë. Është autor dhe bashkautor i një sërë punimesh shkencore dhe profesionale dhe pjesëmarrës në kongrese e simpoziume të ndryshme. (Natyra Karahoda-Gjurgjeala)

RAMADANI Qani (1923-2002). Mësimdhënës, aktivist politik. Lindi në Zhunicë të Preshevës, ku kreu edhe shkollën fillore. Arsimin e mesëm e mori në Medresenë e Madhe në Shkup dhe në Shkollën normale "Sami Frashëri" në Prishtinë. Studioi për biologji-kimi në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Shkup. Ishte pjesëmarrës në luftën antifashiste. Pas Luftës së Dytë Botërore u shqua për veprimtarinë në fushë e arsimit, sidomos të emancipimit të femrës shqiptare në Preshevë dhe më gjerë. Në vitin 1950 emërohet mësimdhënës në gjimnazin e ulët në Preshevë, pastaj edhe drejtor i saj. Në vitet 1960-1981 punoi si mësimdhënës, një kohë edhe drejtor i shkollës fillore "Liria" në Shkup. Kreu edhe funksione të ndryshme politike. (Fadbi Osmani)

RAMADANI Ramadan (1945-2005). Piktur. Lindi në Carralevë të Ferizajit. Shkollimin bazë e mori në vendlindje dhe në Ferizaj, studimet për pikturë i kreu në Akademinë e Arteve në Prishtinë (1979). Ishte anëtar i Shoqatës së Artistëve Figurativë të Kosovës (SHAFK) nga viti 1982. Hapi dy ekspozita të vlerësuara vetjake, më 1982 dhe më 1984 në Prishtinë dhe mori pjesë në vazhdimësi në ekspozitat

e përbashkëta, organizuar nga SHAFK-u, si në Sallonin Pranveror të Kosovës, Bienalen e Vizatimit, pastaj në "Vjeshta figurative e Somborit", si dhe në Sallonin e Cetinës (Mali i Zi). Krijimtaria e tij artistike shquhet për frymën realiste të portreteve, të figurave dhe natyrave të qeta, me kolorit të pasur e të çiltër. (Tahir Emra)

RAMADANI Taip (1972-). Hendbollist, trajner. Lindi në Sidnej të Australisë, ku edhe nisi karrierën si hendbollist. Në vitin 1998 kalon në Hungari, te skuadra "Csomor KSK", më pas në Norvegji, te skuadra "Drammen HK", kurse në vitin 2005 luajti edhe në Katar, te skuadra "Al Gharrafa". Në vitin 2007 u kthye në Australi, ku themeloi klubin "Canberra Handball Club", me të cilin që në edicionin e parë u shpall kampion në Ligën e Uellsit të Ri Jugor. Zhvilloi mbi 100 ndeshje për përfaqësuesen e Australisë (1993-2009). Ai, krahas pjesëmarrjes në Lojërat Olimpikë "Sydney 2000", luajti për Australinë edhe në katër kampionate botërore: në Egjipt (1999), Portugali (2003), Tunizi (2005) dhe Kroaci (2009). Në kampionatin e vitit 2009, Ramadan i ishte ndihmëstrajner i Australisë, kurse pas përfundimit të tij, mori edhe postin e përzgjedhësit. Në krye të përfaqësueses australiane qëndroi deri në vitin 2013. Ai udhëhoqi Australinë në Kampionatin Botëror të vitit 2011 të mbajtur në Suedi dhe botërorin e vitit 2013 të mbajtur në Spanjë. Nga viti 2016 është përzgjedhës i kombëtares së Kosovës në hendboll për meshkuj. (Tahir Sopi)

RAMAJ Abdyl (1943-1999). Pedagog, mësimdhënës, veprimtar politik. Lindi në Reçan të Suharekës, ku kreu edhe shkollën fillore. Të mesmen e filloi në Prizren dhe e kreu në Ferizaj (1965). Studimet për pedagogji i kreu në Fakultetin Filozofik të Prishtinës (1969), ndërsa ato pasunivesitare në Universitetin e Zagrebit. Ishte profesor i lëndëve pedagogjike në Normalen e Prishtinës (1969-1974), pastaj në Shkollën e Lartë Pedagogjike po në Prishtinë. Për shumë vjet ishte redaktor tekstesh shkollorë në Entin e Teksteve dhe të Mjeteve Mësimore të Kosovës, autor dhe bashkautor tekstesh shkollorë dhe profesionale. Ka botuar tekste të ndryshme profesionale, ndër të cilat edhe veprën "Formësimi didaktik i lëndës në tekstin mësimor", botuar pas vdekjes (2001). A. Ramaj ishte veprimtar i Lidhjes Demokratike

të Kosovës, këshilltar komunal, deputet në Kuvendin e Kosovës, veprimtar i Këshillit për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut etj. (Halim Hyseni)

RAMAJ Ragip (1953-). Shkrimtar, gazetar. Lindi në Klinë të Poshtme të Skënderajt, ku kreu shkollën fillore, të mesmen në Skënderaj, kurse studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Një kohë punoi në gjimnazin e Lipjanit, kurse nga viti 1978 në Televizionin e Prishtinës, në redaksinë e emisioneve për fëmijë. Pas mbylljes së këtij institucioni nga pushteti serb, u detyrua të emigronte në Gjermani. Atje u inkuadrua menjëherë në jetën kulturore dhe arsimore të komunitetit shqiptar, ku dha një ndihmesë të çmuar. Po ashtu për nevoja të fëmijëve shqiptarë në diasporë e nxori revistën letrare për fëmijë “Doruntina”. Shkruan kryesisht për fëmijë. Veprat e botuara: “Do të blej një gjysh” (1982), “Dy këmbë për një këpucë” (1986), “Cicërima të shqetësuar” (1999), “Atdheun e kam në zemër” (2002), “Korridorët e shpirtit” (2003), “Molla e kafshuar” (2003), “Gjerdan malli” (2003) etj. Jeton në Gjermani. (Arif Demolli)

RAMAJLI Ilaz (1951-). Politikan. Lindi në Rakaj të komunës së Kaçanikut. Shkollimin fillor e kreu në Kaçanik, gjimnazin në Prishtinë dhe Fakultetin Juridik në Universitetin e



ILAZ RAMAJLI

Prishtinës. Ishte kryetar i organizatës së rinisë në Kaçanik, anëtarë i Kryesisë së Lidhjes së Rinisë Socialiste të Serbisë (1978-1980) dhe kryetar i Gjykatës Komunale në Kaçanik (1982-1986). Ishte anëtar dhe sekretar i Këshillit Ekzekutiv të Kosovës (1986-1989), anëtarë i Kryesisë së Komitetit Krahinor të Lidhjes së Komunistëve të Kosovës, si dhe nënkryetar i Kuvendit të Kosovës (1989-1991). Mori pjesë në shpalljen e Deklaratës Kushtetuese të 2 Korrikut (1990) dhe udhëhoqi mbledhjen e Kuvendit të Kosovës në Kaçanik, në të cilën u aprovua Kushtetuta e Kaçanikut (7 shtator 1990). Po me atë rast u zgjodh kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës (1991-1992) dhe ishte drejtues i Zyrës së Kosovës

në Tiranë (1995-1999). Gjatë periudhës kur Kuvendi i Kosovës veprroi në mërgim (Slloveni), udhëhoqi mbledhjet në të cilat u mor vendimi për mbajtjen e referendumit për Kosovën shtet sovran dhe i pavarur (26-30 shtator 1991), për zgjedhjen e Qeverisë së Përkohshme të Republikës së Kosovës (19 tetor 1991) dhe për shpalljen e zgjedhjeve të përgjithshme për kryetarin dhe Kuvendin e Republikës së Kosovës (2 maj 1992). Është dekoruar me medalje dhe mirënjohje. (Nerxhivane G. Dauti)

RAMAXHIKU Abdurrahman (1937-2007). Mjek, neuropsikiatër, doktor i shkencave dhe profesor. Lindi në Vushtrri. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, të mesmen në Mitrovicë. U diplomua në Fakultetin e Mjekësisë në Shkup më 1964. Pas diplomimit punoi katër vjet si mjek në Shtëpinë e Shëndetit në Vushtrri e më pas në Mitrovicë. Ishte iniciator për hapjen e shkollës së mesme të mjekësisë në Mitrovicë më 1963 dhe të Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë më 1969. Specializimin nga lëmi i neuropsikiatrisë e përfundoi më 1972 në Zagreb. Pas përfundimit të specializimit u punësua si neuropsikiatër në Mitrovicë deri më 1975, kur u zgjodh kryeshef i njërit prej reparteve në Klinikën e Neuropsikiatrisë të Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë. Tezën e doktoratës me titull: “Ndërlëkimet neurologjike të meningjtit seroz dhe purulent në materialin klinik në periudhën 1960-1979” e mbrojti më 1982 në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. Më 1972 u zgjodh asistent, më 1985 docent dhe më 1989 profesor ordinar i lëndës së neuropsikiatrisë në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. Për një periudhë disavjeçare ishte shef i katedrës së neuropsikiatrisë. A. Ramaxhiku u nderua disa herë me mirënjohje dhe çmime nga Fakulteti i Mjekësisë në Prishtinë për kontributin e dhënë në aspektin profesional, arsimor dhe shkencor. Mori pjesë në disa kongrese e simpoziume dhe publikoi shumë punime shkencore si autor dhe bashkautor. (Jusuf Telaku)

RAMIQI Miradije (1953-). Piktore, poete. Lindi në Pozharan të Vitisë. Kreu shkollimin fillor në Pozharan, të mesmin në Gjilan, ndërsa studimet themelore dhe ato pasdiplomike i kreu në Fakultetin e Arteve në Prishtinë. Është piktore e një lirisimi të theksuar dhe abstraksioni modern. Si anëtare e Shoqatës së Artistëve Figurativë të Kosovës nga viti 1981



MIRADIJE RAMIQI

edhe i mirënjohjes dhe medaljes së argjendtë në Sallonin e 34-të të Akademisë Europiane të Arteve në Bruksel (2004). Punoi në Bashkësinë Kulturore Arsimore të Kosovës deri më 1991. Nga viti shkollor 2003/04 punon në Fakultetin e Arteve në Prishtinë, ku ligjëron lëndën e pikturës. (Hajrush Fazliu)

RAMKU G. Refik (1941-). Mjek, otorinolog, doktor i shkencave, profesor. Lindi në Peshkopi të Shqipërisë. Kreu shkollimin fillor në Dibër, ndërsa gjimnazin në Beograd. U diplomua në Fakultetin e Mjekësisë në Beograd (1968). Pas diplomimit u punësua në Vevçan të Strugës, më pas në Qendrën Mjekësore në Gjilan, në Spitalin e Përgjithshëm të Prishtinës dhe në Klinikën e ORL-së të Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë. Specializoi në Beograd në lëmin e ORL-së. Tezën e doktoratës me titull: “Rikonstruktimi i zinxhirit osikular tek inflamacionet kronike të veshit të mesëm” e mbrojti më 1986 në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë dhe më pas mori titullin docent, profesor inordinar dhe profesor ordinar i lëndës së ORL-së në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. Subspecializoi në Tubingen të Gjermanisë për Mikrokirurgji të veshit të mesëm. Gjatë periudhës 1997-99 ishte prodekan dhe ushtrues i detyrës së dekanit të Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë. Ishte shef i repartit të otologjisë. Mori pjesë në shumë kongrese e simpoziume dhe publikoi një sërë punimesh shkencore si autor dhe bashkautor. (Merita Koçinaj)

RAMOSAJ Berim (1962-). Ekonomist, profesor universitar. Lindi në Carrabreg të Ulët, komuna e Deçanit. Shkollimin fillor dhe të mesëm i mbaroi në Deçan, studimet universitare në Prishtinë, ndërsa ato pasuniversitare në Universitetin e Zagrebit. Doktoroi në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës, ku zuri punë që nga viti 1984, në fillim si asistent



BERIM RAMOSAJ

të Fakultetit Ekonomik. Nga fusha profesionale publikoi një numër punimesh shkencore dhe profesionale dhe është autor i disa teksteve universitare nga fusha e menaxhmentit dhe e lidershit (“Bazat e menaxhmentit”, “Menaxhimi kreativ dhe liderशिpi”, “Menaxhimi financiar”). Ka qenë deputet i Parlamentit të Kosovës në dy mandate (2007-2010), shef i ekzekutivit të komunës së Prishtinës (2000-2003) dhe këshilltar për ekonomi në Presidencën e Kosovës (2003-2010). (Sinan Ademaj)


RAMOSAJ Fetnete (1972-). Veprimtare, luftëtare e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Lindi në fshatin Carrabreg i Poshtëm të komunës së Deçanit. Që nga viti 1989 bënte pjesë në lëvizjen ilegale. Më 27 mars 1998, në Gillogjan, në varrimin e dëshmorëve të betejës së 24 marsit doli publikisht, duke bërë thirrje për mobilizim të përgjithshëm në luftë për liri. Gjatë viteve 1998-1999 kreu detyrën e zëdhënësës së UÇK-së për Zonën Operative të Dukagjinit dhe ishte oficer ndërlidhëse e kësaj zone për koordinimin e sulmeve ajrore të NATO-s. Njëkohësisht raportoi për Agjencinë e lajmeve “Kosovapress”, për Radion “Kosova e lirë” dhe Radio Televizionin Shqiptar, si dhe bashkëpunoi me radiot dhe agjencitë e huaja të lajmeve. Pas përfundimit të luftës u angazhua në Trupat Mbrojtëse të Kosovës. Është bashkautore e monografisë “Deçani” (1997) dhe autore e librave “Krimet serbe në Kosovë” (shqip dhe anglisht, 2005, 2008) dhe “Organizatata ekstremiste serbe në Kosovë” (2013, 2015) i botuar edhe në gjuhë të huaja. Është autore e ekspozitës “Terrori dhe gjenocidi i Serbisë në Kosovë 1998-1999” (2015). (Faton Mehmetaj)

RAMUSHOLLI Ilmi (1964-). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Lindi në fshatin Manastirc të Ferizajt. Punoi në shkollat fillore në Petrovë të Shtimes dhe në Nerodime të Epërme. Në qershor të vitit 1998

dhe pastaj në cilësinë e profesorit të lëndëve: bazat e menaxhmentit, sjetllje organizative, liderशिp dhe menaxhment financiar. Ligjëroi edhe në disa kolegje private dhe kreu funksione me përgjegjësi në kuadër të organizimit institucional

iu bashkua UÇK-së. Me shtimin e radhëve të UÇK-së dhe me organizimin e ri u emërua komandant skuadre, togu etj. Pas betejës së Jezercit (tetor 1998), Komanda e Zonës Operative të Nerodimes (ZON) e emëroi zëvendëskomandant të batalionit dhe më 10 janar 1999 shef të Shtabit të Brigadës 161 në Mollopolc. U plagos gjatë luftës në Jezerc. Më 15-19 janar 1999 mori pjesë në luftimet kundër ushtrisë serbe në Reçak. Më 24 janar 1999 Shtabi i ZON-it e emëroi komandant të Brigadës 161 "Ahmet Kaçiku", detyrë që e kreu deri me demobilizimin e UÇK-së. Pas luftës u angazhua në Trupat Mbrojtëse të Kosovës dhe në Forcën e Sigurisë së Kosovës. (Ali Uka)

RANDOBRAVA Reshat (1939-). Kompozitor. Lindi në Prizren, ku kreu shkollimin fillor dhe të mesëm të muzikës. Punoi si arsimtar i muzikës në gjimnazin e Prishtinës, ku udhëhoqi korin e shkollës. Më 1961 u regjistrua në Akademinë e Muzikës në Beograd dhe kreu shkollën I, ndërsa shkollën II e kreu në Akademinë e Muzikës në Sarajevë (1967). Në shtator të atij viti u emërua mësimdhënës në Shkollën e Mesme të Muzikës në Prishtinë (1967-1972). Në vitet vijuese ishte producent i muzikës së lehtë, redaktor i produksionit muzikor dhe redaktor përgjegjës në Radiotelevizionin e Prishtinës deri në largimin kolektiv në korrik të vitit 1990. Më 1985 ishte drejtor i "Akordeve të Kosovës", ndërsa më 1986 themelues i Festivalit "Zambaku i Prizrenit". Ka qenë kryetar i Shoqatës së Kompozitorëve të Kosovës (1988-1990). Që nga shkolla e mesme dhe për pesë dekada kompozoi më se 200 melodi të muzikës së lehtë dhe për fëmijë. Fryt i asaj pune janë disqet: "Të keqen munde me këngë" (bashkëpunim me poetin A. Vinca dhe aktorin Ç. Lajqi), kompozime me poezi të D. Agollit, "Këngët më të suksesshme", "Jetë e këngë" (versioni instrumental), "Tungjatjeta" (kushtuar Prizrenit), Kompozime me poezi të Asdrenit, "Bregu ëndërrtar" (me tekste poetësh kosovarë) etj. (Xhevdet Gashi)



RESHAT
RANDOBRAVA

RANDOBRAVA-KAÇANIKU Hylkije (1945-). Mësimdhënese dhe veprimtare e arsimit. Lindi

në Prishtinë, shkollën fillore dhe të mesmen i kreu në Mitrovicë, studioi pedagogjinë në Fakultetin Filozofik në Prishtinë, ku mbrojti edhe temën e magjistraturës. Ishte mësimdhënese në gjimnazin, përkatësisht në Shkollën Normale të Mitrovicës, pastaj në disa shkolla të mesme në Prishtinë. Punoi në Entin Pedagogjik të Prishtinës si këshilltare për mësimin klasor dhe institucione parashkollore, si dhe në Drejtorinë e Arsimit të Komunës së Prishtinës. Ka botuar edhe disa shkrime pedagogjike. (Afërdita Kumnova-Mulla)

RANILLUGU. Fshat dhe qendër e komunës me të njëjtin emër. Shtrihet rreth 13 km në jug të Kamenicës dhe 15 km në lindje të Gjilanit. Lartësia mbidetare është 420 m. Me emrin



RANILLUGU

Ranilluk është regjistruar në sallnamet e vilajetit të Kosovës të vitit 1893, 1896 dhe 1900. Në vitin 1948 kishte 975 banorë, kurse në vitin 2011 u regjistruan 844 banorë. Veprimtaritë kryesore ekonomike janë bujqësia dhe blegtoria. Nga objektet e standardit shoqëror ka shkollën fillore, dy shkolla të mesme, stacionin shëndetësor, zyrën e vendit etj. (Muhamed Kallaba)

RANILLUGU (komuna). Komunë në lindje të Kosovës, në rajonin e Anamoravës me qendër fshatin Ranillug. Sipërfaqja 78 km². Në veri kufizohet me komunën e Kamenicës, në veriperëndim me komunën e Novobërdës, në jugperëndim me komunën e Gjilanit dhe në lindje me komunën e Bujanocit. Ka 13 vendbanime, me dendësi mesatare të banimit prej 49.6 b/km². Sipas regjistrimit të fundit 2011 kishte 3,866 banorë. Është komunë tipike agrare, e cila u themelua në vitin 2010, me procesin e decentralizimit, sipas rekomandimeve nga pakoja e Ahtisarit. Komuna ka

kushte të mira për zhvillimin e bujqësisë intensive. (Muhamed Kallaba)

RANKOVIQ Aleksandar (1909-1983). Funkionar i lartë komunist i Jugosllavisë, udhëheqës i OZN-ës nga themelimi deri në vitin 1966. Lindi më 1909 në fshatin Drazhevac, afër Obrenovcit (Serbi). Më 1928 anëtarësohet në PKJ dhe emërohet sekretar i komitetit rajonal të organizatës së rinisë komuniste. Ishte njëri ndër organizatorët dhe udhëheqësit e LNÇ-së, bashkëluftëtar dhe kumbar i Titos. Pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore u emërua ministër i Punëve të Brendshme i Jugosllavisë (1946-1966) dhe drejtues i OZN-ës që nga 13 maji 1944. Më 1948 udhëhoqi aksionin kundër informbyroistëve, duke burgosur dhe internuar numër të madh kundërshtarësh ideologjikë dhe partiakë. U bë simbol i dhunës ushtarake e policore për likuidimin fizik dhe për shpërngulje me dhunë të shqiptarëve, iniciator kryesor i aksionit të armëve në dimrin e viteve 1955-56. Nga viti 1956 ishte nënkryetar i Këshillit Ekzekutiv Federativ dhe anëtar i organeve më të larta partiake dhe shtetërore të Jugosllavisë. Në Plenumin IV të LKJ-së në Brione, më 1 korrik 1966, Tito e shkarkoi nga të gjitha funksionet në parti dhe në pushtet, me pretekstin se shërbimi i sigurimit shtetëror kishte përgjuar edhe vetë Titon. U pensionua dhe deri në vdekje jetoi në villën e tij në Dubrovnik. (Naim Musliu)

RAPORTET E PROGRESIT TË KOMISIONIT EUROPIAN PËR KOSOVËN (2007-2015). Dokumente vjetore të përgatitura nga Komisioni European, në të cilat matet përparimi i arritur njëvjeçar i Kosovës në integrimin european. Raportet e Progresit bëhen publike si pjesë e pakos së zgjerimit, ku Komisioni European mbarështron politikën e përgjithshme të zgjerimit. Gjatë vitit institucionet e vendit prezantojnë të arriturat, të cilat evidentohen nga shërbimet e Komisionit, si aktivitetet legislative ashtu edhe masat e tjera që kanë përmirësuar gjendjen në sektorë të ndryshëm. Për përgatitjen e Raportit të Progresit, Komisioni European shërbehet me burime plotësuese, takime me pjesëtarë të shoqërisë civile, studime, hulumtime, anketa dhe raporte të tjera të agjencive profesionale, të institucioneve publike etj. Raportet evidentojnë gjendjen në vend sipas kriterëve

konkrete politike, ekonomike dhe sociale. Në raporte analizohet situata politike e Kosovës për sa i përket demokracisë, sundimit të ligjit, të drejtave të njeriut, mbrojtjes së pakicave dhe çështjeve rajonale. Në pjesën ekonomike analizohet gjendja ekonomike në vend gjatë vitit të raportimit, bashkë me vlerësimin e kapaciteteve të institucioneve të vendit për zbatimin e standardeve europiane. Matja e përparimit të arritur shprehet me terma me kuptim të qartë, si: “s’ka progres”, “progres i kufizuar”, “progres i kënaqshëm”, “progres i mirë”. Bazuar në gjetjet e Raportit të Progresit, institucionet e vendit përgatisin Planin e Veprimit të Partneritetit European (PVPE), në të cilin përcaktohen hapat që duhen ndërmarrë dhe identifikohen institucionet përgjegjëse për zbatimin e tyre. Më aprovimin e PVPL-së nga Qeveria zotimet e parapara sipas planit shndërrohen në obligime për institucionet përgjegjëse. Niveli i përmbushjes së detyrave matet në takime periodike, ndërsa rolin bashkërendues në këtë proces e luan Ministria e Integritit European. Nga ana e institucioneve të vendit Raportet e Progresit janë vlerësuar rregullisht si inkurajuese e reale, përderisa përfaqësuesit e opozitës dhe të shoqërisë civile i kanë nënvizuar vërejtjet e shumta, të cilat zakonisht janë evidentuar në këto raporte. Emërues i përbashkët i vërejtjeve më të mëdha të dala nga raportet e progresit janë ato për fushën e sundimit të ligjit (mosefikasitet, korrupsion e ndërhyrje politike), të demokracisë (mbikëqyrje të pamjaftueshme parlamentare) dhe ekonomike (funksionimi i ekonomisë së tregut, struktura sektoriale e ndërmarrësisë). Gjetjet e Raportit të Progresit rregullisht paraqesin pjesë të debatit në Kuvendin e Kosovës dhe jashtë tij dhe ofrojnë një orientim të rëndësishëm për fushat në të cilat duhen ndërmarrë reforma. Komisioni European ua prezanton gjetjet e raportit anëtarëve të Parlamentit European dhe shteteve anëtare. (Ilir Dugolli)

RASIA-RASHA-SERBIA. Emër i përgjithshëm sllav, që është përdorur për një kohë të gjatë për sllavët e jugut, që nga shpërngulja e tyre në Ballkan. Gjatë mesjetës, sllavët jetuan të ndarë në fise, fenomen që pasqyrohet edhe me ekzistimin e trajtës në shumë *Sklavininë*. Po me këtë kuptim e përdornin Skllavininë edhe Konstandin Porfirogjeneti dhe burime të tjera

relevante të shek. X-XII. Janë ruajtur emra të popujve sllavë edhe sipas traditës bizantine, të veshur me emra të antikitetit: mizët (bullgarët), dalmatët ose tribalët (serbët e kroatët) etj. Ndërkaq, origjina e emrit të shtetit mesjetar serb, *Rasia, Rasha (Rassa, Rasia, Rassia, Rascia, Raxia* etj.) lidhet me emrin e lumit Rasha, si dhe emrin e qytetit fortifikatë Ras. Sidoqoftë, emri Rasia (Rasha) i paraprinte emrit Serbia, Surbia. Në shek. IX përdoret emri i Ipeshkvisë së Rashës, e cila pas vitit 1020 zakonisht përmendet si pjesë e Argjipeshkvisë së Ohrit. Rasia ndonjëherë paraqitet së bashku me Serbinë. Megjithatë, më shpesh e ndeshim të ndarë: *Surbia* (Serbia) sipas Abatit të Dioklesë (shek. XII) shkante deri te *Lapiam* (Llapi i sotëm). Më 1186, me rastin e pushtimit të Kotorrit nga Nemanja, burimet zyrtare të qytetit e quanin, “Nemanja zhupan i Rashës” (*Nemanne iupani Rasse*). Sipas burimeve hungareze të kohës së mbretit Bela III (1172-1196) e ndeshim trajtën “toka Rasi” (*terram Rasy*). Një anonim i vitit 1308, Milutinin e quante për “mbret e zotërues të Dalmacisë, Kroacisë, Dioklesë, Serbisë dhe Rashës” (*Dalmatie, Croatie, Dyoclie, Servia ac Rasio rex et dominus*), ndërsa thuhet: Arbëria në kufij me Rashën dhe Bullgarinë (sipas Bertrandon de la Broquière, 1400-1459). Despoti Gjuragj Brankoviq është quajtur nga mbreti hungarez Sigismund “dukë e despot i gjithë mbretërisë së Rashës dhe Arbërisë” (“*ducem et despotum totius regni Rascie et Albaniae*”) etj. (Jahja Drançolli)

RASPASANI (Raspasari) Toma (shek. XVII-XVIII). Murg françeskan dhe zëvendës i argjipeshkvit të Shkupit, Pjetër Bogdani. Së bashku organizuan lëvizjen proaustriake të shqiptarëve në kohën e luftës austro-osmane 1683-1699. Vendlindja e tij nuk dihet me siguri, por supozohet të ketë qenë Jeni Pazar (në burime të hershme Ras-Pazar). Shkollimin teologjik bazë e kreu në Janjevë. Pas përfundimit të studimeve teologjike në Itali u emërua prift në famullinë e Prizrenit (1679). Toma Raspasani luajti një rol të rëndësishëm në vitet 1689-1690, kur gjenerali Pikolomini vendosi kontaktet me shqiptarët e Kosovës për luftë të përbashkët kundër osmanëve. Ishte krahu i djathtë i Pjetër Bogdanit gjatë marrëveshjeve me Pikolominin. Sipas disa burimeve, Raspasani ishte personi kryesor në grumbullimin e madh të shqiptarëve për luftën antiosmane. Pas vdekjes

së Pjetër Bogdanit (dhjetor 1689), Raspasani zuri vendin e tij si argjipeshkëv i Shkupit, por edhe si udhëheqës i lëvizjes shqiptare antiosmane. Raspasani ishte shumë aktiv si gjatë luftës, ashtu edhe pas disfatës austriake dhe tërheqjes në Nish e pastaj në Hungari. Pas Betejës së Kaçanikut (janar 1690), Toma Raspasani me tepricën e ushtrisë së thyer, me një pjesë të regjimentit kalorsiak “Pikolomini” dhe me një pjesë të “Milicisë shqiptare”, nën komandën e nënkolonelit Anton Znoriq mbeti në Prizren. Komandanti i ri i ushtrisë austriake, konti Veteran, që posa kishte mbërritur në Nish, urdhëroi që i gjithë garnizoni në Prizren me françeskanin Tomë Rasanin në krye të tërhiqej nëpërmjet Jeni Pazarit në Beograd, sepse Prizrenin nuk kishte mundësi ta mbronte. Teprica e ushtrisë austriake dhe vullnetarët shqiptarë të udhëhequr nga Anton Znoriq dhe Toma Raspasani u shpërngulën për në fushën e Panonisë, nën sundimin austriak. Nga frika e hakmarrjes osmane, një numër shqiptarësh, kryesisht të krishterë e lëshuan Kosovën dhe u vendosën në Hungari dhe, siç shkruante Raspasani vite më vonë, shumë prej tyre vdiqën ose nga uria ose nga sëmundjet. (Gazmend Rizaj)

RASHANI Shefqet (1944-). Inxhinier i teknologjisë, profesor universiteti. Lindi në Rashan të komunës së Mitrovicës. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Mitrovicë, ndërkaq studimet



SHEFQET RASHANI

në Fakultetin Teknik të Universitetit të Sarajevës në Tuzëll (1969). Pas diplomimit punoi në Kombinatin Xehetar Metalurgjik “Kosova”. Studimet pasuniversitare i kreu në Tuzëll, si dhe mbrojti tezën e doktoratës (1976). Në vitin 1972 u zgjodh ligjërues në Fakultetin e Xehetarisë dhe të Metalurgjisë të Universitetit të Prishtinës (UP), ku më pas avancohet në të gjithë titujt universitarë. Në studimet master dhe të doktoratës ishte titullar i disa lëndëve bazë, si: termodinamika kimike dhe kinetika e reaksioneve kimike, pastaj termodinamika dhe termoteknika, bazat teorike të teknologjisë kimike, reaktorët etj. Është autor dhe bashkautor i një sërë punimesh shkencore të botuara në revistat ndërkombëtare dhe i

shumë artikujve shkencorë të botuar në revista vendore. Është gjithashtu autor i 6 teksteve mësimore dhe i monografive: “Termodinamika inxhinierike kimike” (1987), “Termodinamika dhe termoteknika” (2010) etj. Ushtri funksione drejtuese në Fakultetin e Xehetarisë dhe të Metalurgjisë dhe në organet drejtuese të UP-së. (Avni Terziqi)

RASHITI Sadik (1944-). Filozof, profesor universiteti. Lindi në Pogradec të Gjiçanit, ku mbaroi shkollën fillore dhe të mesme, ndërsa studimet themelore i mbaroi në Universitetin e Prishtinës (UP), në katedrën e pedagogjisë të Fakultetit Filozofik (1968). Kreu studimet pasuniversitare në Universitetin e Zagrebit, në degën e filozofisë (1974), doktoraturën e mbaroi në Fakultetin Filozofik të UP-së. Në vitet 1986/87



SADIK RASHITI

realizoi një qëndrim studimor në Universitetin e Sankt-Petersburgut, në ish-BRSS, ku mori njohuri shtesë nga fusha e etikës dhe e filozofisë së moralit. Karrierën universitare e filloi në vitin 1973, si ligjërues në Fakultetin Filozofik të UP-së, më vonë në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore, duke u avancuar në titujt e tjerë universitarë. Nga viti 2000 kaloi me punë në Fakultetin e Edukimit dhe ushtri edhe detyrën e prodekanit dhe të dekanit po në këtë fakultet. Ka botuar monografitë “Kategoria e ndërgjegjes” (1997), “Traktate filozofike-politike” (2003) dhe një numër punimesh profesionale-shkencore brenda dhe jashtë vendit. (Gëzim Selaci)

RASHITI-GLOBODER Agnesa (1975-). Gazetare. Lindi në Prishtinë. Shkollën fillore dhe të mesme i mbaroi në Prishtinë, si dhe studimet për gjuhë, letërsi angleze dhe turke i mbaroi në Universitetin e Prishtinës. Fillimisht punoi si mësimdhënëse e gjuhës angleze në shkollën fillore “Elena Gjika” dhe në gjimnazin “Sami Frashëri” në Prishtinë. Në nëntor të vitit 1999 hapi programin në gjuhën turke në radion “Blue Sky”, ku vazhdon të punojë edhe tani. Në vitet 2005-2010 ishte nënkryetare e shoqatës kulturore turke “Gerçek”. Mori pjesë në shumë seminare të gazetarisë në Turqi, SHBA etj. Punoi në Radio Kosova (RTK-

Radio), si gazetare dhe redaktore e emisioneve për fëmijë. (Ibrahim Berisha)

RATKOVI. Fshat në komunën e Rahovecit. Shtrihet në lartësi mbidetare 350 m. Është vendbanim fushor i tipit të grumbulluar. Sipërfaqja kadastrale është 11.3 km². Përmes rrugës së asfaltuar lidhet me magjistralen Prizren-Gjakovë, ndërsa nëpër fshat kalon hekurudha Prizren-Klinë. Në defterin kadastral të vilajetit Vëllk (1455) ishte i regjistruar me emrin Ratkovica, me 27 shtëpi. Në vitin 2011 Ratkoci kishte 3,791 banorë, ndaj 1,224 banorëve në vitin 1948. Popullsia merret me bujqësi, blegtori, tregti, zejтари etj. Nga objektet e standardit shoqëror ka shkollën fillore dhe të mesme, stacionin shëndetësor, shtëpinë e kulturës, tregun, zyrën e ofiqarisë etj. Ratkoci është bashkësi lokale, në të cilën gravitojnë vendbanimet Dejnë, Radostë, Vrajak dhe Bratotin. (Idriz Shala)

RAUSHIQI. Fshat në komuna e Pejës, rreth 5 km në jug të qytetit. Ndodhet në lartësi mbidetare 510 m, përgjatë rrugës Pejë-Deçan. Është vendbanim fushor i tipit të dendur. Sipërfaqja e territorit të fshatit është 726 ha, nga e cila 90% janë ara, ndërsa pjesën tjetër e zënë livadhet. Popullsia merret kryesisht me kultivimin e grurit, misrit etj. Në dokumentet e shkruara përmendet në krisobulën e Manastirit të Deçanit të vitit 1330. Në vitet 1836-1938 në hartën e Lepieut figuronte me emrin Raouchitza. Me emrin Rahoshiq është regjistruar si vendbanim në sallnamet e vilajetit të Kosovës të vitit 1893, 1896 dhe 1900. Derisa në vitin 1921 fshati kishte 553 banorë, në vitin 2011 ka 2,260 banorë. Nga objektet e standardit shoqëror ka shkollën fillore, stacionin shëndetësor, disa dyqane tregtare etj. (Bajram Kafexholli)

RECESIONI. Fazë e ciklit të biznesit, që karakterizohet me rënien e prodhimit, të çmimeve dhe të fitimit, si dhe me rritje të papunësisë dhe e falimentimeve në masë. Është momenti kur për shkak të disproporcionit midis ofertës dhe kërkesës ngec shitja dhe prodhimi i mallrave, bie aftësia blerëse e shtresave të gjera dhe rritet papunësia. Gjatë viteve të shkuara në Kosovë ka munguar përdorimi i derivateve financiare, siç i përdorin tregjet e zhvilluara financiare. Për këtë arsye

efektet negative të recesionit global nuk ishin shumë të theksuara. Në Kosovë efektet negative të recesionit global financiar pas vitit 2008 kanë qenë më të theksuara në sektorin e ndërtimeve, në realizimin e të ardhurave nga dërgesat e punëtorëve jashtë vendit (vëllimi i dërgesave u zvogëluar nga 15.1 % në vitin 2007 në 12.9% në vitin 2010). Përveç kësaj, një sektor ku janë reflektuar efektet negative të recesionit kanë qenë edhe investimet e jashtme të drejtpërdrejta (nga 545 milionë euro në vitin 2007, në 292 milionë në vitin 2010). (Myrvete Badivuku- Pantina)

REÇAKU. Fshat në komunën e Shtimes, rreth 3 km në perëndim të qytetës. Territori i fshatit ka sipërfaqe prej 4.5 km². Është vendbanim i vjetër, që dëshmohet nga gjetjet arkeologjike. Përmendet në disa dokumente të vjetra. Për herë të parë përmendet në dokumentet e vitit 1343. Me të njëjtin emër përmendet edhe në sallnamet e vilajetit të Kosovës (1893, 1896 dhe 1900). Në vitin 1948 kishte 613 banorë, ndërsa në vitin 2011 u regjistruan 1,638 banorë. Dendësia e banimit është 369 b/km². Në këtë fshat gjatë luftës së fundit ushtria dhe policia serbe masakroi 43 civilë, gjë që u bë shkas për ndërhyrje ndërkombëtare. Për këtë arsye, Reçaku u bë njëri nga simbolet e sakrificës për çlirimin e Kosovës. Fshati i takon bashkësisë lokale të Shtimes II. (Shpend Agaj)

REÇANI. Fshat në komunën e Prizrenit, 9 km në juglindje të qendrës, shtrihet në pjesën më perëndimore të Zhupës, pranë Lumëbardhit të Prizrenit, në lartësi mbidetare 600 m. Është vendbanim i tipit të dendur, me sipërfaqe 4.9 km². Në dokumentet e shkruara mesjetare përmendet me të njëjtin emër. Në defterin e Sanxhakut të Prizrenit të vitit 1530 figuronin dy vendbanime: Reçani Bozorg (Reçani i Madh) me 30 shtëpi dhe Kuçuk Reçani (Reçani i Vogël) me 20 shtëpi. Shumë banorë të fshatit emigruan brenda dhe jashtë Kosovës. Megjithatë, numri i popullsisë së fshatit shënoi rritje të vazhdueshme. Reçani është bashkësi lokale, në të cilën gravitojnë pothuajse të gjitha vendbanimet e Zhupës. Popullsia merret me veprimtari shërbyese-hoteliere, një pjesë e vogël me blegtori (gjedhe të imta) etj. Nga objektet e standardit shoqëror, fshati ka shkollën 9-vjeçare, shkollën e mesme, shtëpinë e kulturës, shtëpinë e shëndetit, disa pika tregtare etj. (Hasim Kryeziu)

REÇICA Elmi (1961-). Veprimtar politik, luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Lindi në Ferizaj. Kreu studimet në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës. Që herët u përfshi në lëvizjen ilegale. U arrestua në nëntor të vitit 1985 dhe u dënua me 11 vjet burg “për veprimtari armiqësore”. Pas fillimit të shpërbërjes së shtetit jugosllav (1991) u lirua nga burgu dhe vazhdoi veprimtarinë në Këshillin për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut. Me fillimin e luftës së armatosur u angazhua për ngritjen dhe zgjerimi e radhëve të UÇK-së. Në periudhën 1998-1999 ishte anëtar i Shtabit të UÇK-së për Zonën Operative të Nerodimes. Më pas u angazhua në sektorin e sigurisë, ku ushtroi funksionin e zëvendëshefit të Shërbimit Informativ të Kosovës (1999-2008). Në zgjedhjet e vitit 2010 dhe 2014 u zgjodh deputet i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës. (Ruzhdi Jashari)

REÇICA Sefedin (1955-). Hendbollist. Lindi në Ferizaj, ku kreu shkollimin fillor dhe të mesëm, ndërsa Fakultetin e Kulturës Fizike e kreu në Prishtinë. I takon brezit më të suksesshëm të klubit të hendbollit “Borci” të Ferizajt. Gjatë kohës sa luajti për këtë skuadër, arriti suksesin më të madh të karrierës. Me “Borcin” luajti në finale të Kupës së ish-Jugosllavisë në vitin 1978. Ishte edhe anëtar i përfaqësueses së të rinjve të ish-Jugosllavisë, ndërsa më vonë u bë trajner i po këtij ekipi. Jeton dhe punon në Liezh të Belgjikës. (Lulzim Shala)

REFERENDUMI PËR AUTONOMI POLITIKE-TERRITORIALE TË SHQIPTARËVE TË MAQEDONISË (“ILIRIDA”). Deklarimi i shqiptarëve të Maqedonisë për statusin politiko-juridik, pas shpërbërjes së Federatës Jugosllave. Pas përfundimit të referendumit maqedonas të 8 shtatorit 1991 dhe aprovimit të Kushtetutës së vitit 1991, faktori politik shqiptar kërkoi rrugë tjetër për zgjidhjen e çështjes së shqiptarëve të Maqedonisë. Një nga këto ishte organizimi i një referendumi të veçantë, ku populli shqiptar i Maqedonisë do të shprehte vullnetin e vet përmes deklaramit gjithëpopullor. Referendumi për “Iliridën” erdh si kundërpërgjigje ndaj të gjitha vendimeve të njëanshme të faktorit politik maqedonas, që marginalizonin politikisht shqiptarët. Referendumi i organizuar nga

Partia e Prosperitetit Demokratik, mbështetur nga Partia Demokratike Popullore, u mbajt më 11 e 12 janar 1992. Vendimin për shpalljen e referendumit për autonomi politike-territoriale të shqiptarëve në Maqedoni e nxori “Kuvendi i Autonomisë” më 27 dhjetor 1991. Qytetarët shqiptarë duhej të deklaroheshin: “A janë për autonomi politike-territoriale të shqiptarëve në Maqedoni?”. Referendumi u organizua në të gjitha qytetet me shumicë shqiptare, kurse rezultatet treguan se shumica e shqiptarëve në Maqedoni mbështetnin autonominë politike-territoriale të shqiptarëve në Maqedoni: nga 383,539 votues në mbështetje të autonomisë u deklaruan 360.928 sish, ose 99.9%, kundër ishin 57 votues dhe 570 fletëvotime dolën të pavlefshme. (Arsim Sinani)

REFERENDUMI PËR BASHKIMIN E LUGINËS SË PRESHEVËS ME KOSOVËN (1992).

Deklarimi popullor i shqiptarëve të Luginës së Preshevës, i mbajtur më 1 dhe 2 mars 1992, në të cilin shqiptarët në Luginë të Preshevës (Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë) u deklaruan për autonomi territoriale me të drejtë bashkimi me Kosovën. Pjesëmarrës ishin mbi 46 mijë qytetarë, 98 për qind e të cilëve kishin zgjedhur opsionin e autonomisë territoriale me të drejtë bashkimi me Kosovën. Dy opsionet e tjera ishin: autonomi territoriale-politike dhe autonomi administrative-kulturore në Serbi. Ky referendum u mbajt në atmosferën e shpërbërjes së ish-Jugosllavisë dhe të ristrukturimit të shteteve të dala prej saj, si dhe nën ndikimin e drejtpërdrejtë të zhvillimeve në Kosovë. Në anë tjetër, referendumi shprehte kërkesën e mëherëshme të Luginës së Preshevës për bashkim me Kosovën, artikulluar që në vitin 1968 përmes demonstratave të përbashkëta që atëbotë organizoheshin në Kosovë. Referendumi për bashkimin e Luginës së Preshevës me Kosovën nuk prodhoi efekte juridike, por vetëm politike. (Qerim Qerimi)

REFERENDUMI PËR REPUBLIKËN E KOSOVËS (1991). Deklarimi i popullit të Kosovës për Republikën e Kosovës, i cili u mbajt në rrethanat e shpërbërjes së ish-Jugosllavisë, pas Deklaratës Kushtetuese të 2 Korrikut 1990 dhe Kushtetutës së 7 Shtatorit 1990 në Kaçanik. Jugosllavia ishte në procesin e shpërbërjes dhe secila njësi e saj federale ndërmerre veprime për t’u deklaruar për shtetësinë e



REFERENDUMI PËR REPUBLIKËN E KOSOVËS MË 1991

vet. Referendumi popullor për Kosovën shtet i pavarur dhe sovran ishte një akt i vetëpërcaktimit demokratik e politik i popullit shumicë të Kosovës, për statusin kushtetues dhe politik të saj, pas shpërbërjes së ish-Jugosllavisë. Referendumi paraqiste një akt legjitim të deklarimit politik të popullit shumicë të Kosovës, i cili, sikundër edhe popujt e tjerë të ish-Jugosllavisë, synonte të përcaktohej qartë për të ardhmen e vet. Referendumi popullor në Kosovë u organizua prej 26-30 shtator 1991. Pjesëmarrja dhe rezultati i referendumit bënë të qartë se populli shqiptar ishte përcaktuar për Kosovën shtet i pavarur dhe sovran. Numri i përgjithshëm i qytetarëve me të drejtë vote ishte 1,051,357, në referendum dolën 914,802 votues (87.19%), ndërsa për Kosovën shtet i pavarur dhe sovran ishin deklaruar 913,705 votues ose 99.87%, kundër kishin votuar 164 persona, ndërsa të pavlefshme ishin 933 fletëvotime. Këtij rezultati të referendumit popullor iu bashkëngjit Rezoluta e Kuvendit të Kosovës për shtet të pavarur dhe sovran e datës 18 tetor 1991, akt që i dha legalitet rezultatit të referendumit. Me këtë rezolutë u konfirmua deklarimi i popullit të Kosovës për sovranitetin dhe pavarësinë e plotë të Kosovës. Përcaktimi i popullit të Kosovës nëpërmjet referendumit dhe Rezoluta e Kuvendit për Kosovën për shtet të pavarur dhe sovran konfirmuan vullnetin politik të shqiptarëve si shumicë e popullit të Kosovës për statusin e ardhshëm të Kosovës. Bashkësia ndërkombëtare nuk e njohu këtë referendum, prandaj ai nuk prodhoi efekte juridike, por vetëm efekte politike. (Esat Stavileci)

REFORMA AGRARE (1918-1941). Proces i shpronësimit agrar të shqiptarëve në Kosovë

dhe kolonizimi i saj, të cilin e zhvilloi Serbia në disa periudha kohore, që nga viti 1912 e tutje. Procesi i filluar në vitet 1913-1915, u ndërpre, për shkak të Luftës së Parë Botërore. Më 1918, Serbia rifilloi më intensivisht shpronësimin agrar të shqiptarëve dhe kolonizimin me banorë sllavë të Kosovës dhe të viseve të pushtuara shqiptare. Qëllim i kësaj politike të Mbretërisë Serbe-Kroate-Slllovene (MSKS) ishte ndërrimi i strukturës etnike të territoreve shqiptare. Për këtë arsye MSKS nxori legjislacionin agrar-kolonizues, duke filluar me ligjin e 25 shtatorit të vitit 1919 dhe duke vazhduar deri në nxjerrjen e ligjit të vitit 1931, i cili do të plotësohet dhe ndryshohet në vitin 1933. Për jetësim të suksesshëm të "Reformës agrare" dhe të kolonizimit u krijua Ministria e Reformës Agrare, kurse në Shkup u ngrit Drejtoria e Lartë Agrare, me degë në disa qytete shqiptare. Pothuajse i tërë legjislacioni i vinte në pozitë diskriminuese fshatarët shqiptarë, kundrejt minoritetit serbo-malazias dhe kolonëve të ardhur nga viset e tjera të MSKS-së.

Në shënjestër të shpronësimit u gjendën të parat pronat tokësore të aktivistëve të dalluar të lëvizjes kombëtare. U shpronësuan edhe tokat e ashtuquajtura të braktisura, ku përfshiheshin kullotat e përbashkëta të fshatarëve dhe tokat e pronarëve shqiptarë që përkohësisht e kishin braktisur vendin, për shkak të pasigurisë së jetës. Shpronësimi dhe zvogëlimi i sipërfaqes së tokës së punueshme arriti masat alarmante pas vitit 1923, kur komisioneve agrare u lejohej që të sekuestrojnë, sipas nevojës, edhe toka që nuk ishin paraparë në legjislacion. Shfrytëzohej edhe mungesa e tapive të tokave të shumicës dërrmuese të fshatarësisë shqiptare, e cila i trashëgonte ato që nga periudha e sundimit osman. Pronarët e këtyre tokave i shpronësonin si uzurpatorë tokash.

Ligji i vitit 1931, me plotësime dhe ndryshime në vitin 1933, mundësonte që shqiptarëve t'u sekuestrohej toka deri te pragu i shtëpisë. Nuk përjashtoheshin rastet, sidomos në Rrafshin e Dukagjinit, kur kolonët serbo-malazezë vendoseshin edhe në katet e sipërme të shtëpive, kurse pronarët shqiptarë me familje ishin të detyruar të jetonin në katin përdhës të shtëpive të tyre. Shpronësimit nuk i shpëtuan as pronarët e institucioneve fetare shqiptare, si myslimane, ashtu edhe katolike.

Dëmin kryesor nga kjo reformë agrare e pësoi fshatarësia shqiptare, e cila përbënte 90%

të popullsisë së Kosovës. Ajo nuk zotëronte sipërfaqe të mëdha (vetëm 10% e familjeve kishin në pronësi mbi 10 ha) dhe përgjithësisht përbëhej nga familjet me shumë anëtarë. Përmes një legjislacioni agrar specifik, në periudhën 1919-1941, në viset ku jetonte popullsia shqiptare u shpronësuan rreth 218 mijë ha tokë, nga të cilat mbi 192 mijë në Kosovë. (Lush Culaj).

REFORMA AGRARE. Që nga mbarimi i Luftës së Parë Botërore dhe deri tani në Kosovë janë ndërmarrë disa reforma agrare. Në periudhën 1918-1938 u realizua reforma agrare që pati për qëllim shpronësimin e popullatës shqiptare dhe vendosjen e kolonëve serbë. Kjo reformë u realizua nëpërmjet Bankës Agrare Serbe. Pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore janë ndërmarrë disa reforma agrare, duke filluar nga eksproprijimi, nacionalizimi dhe shpërndarja e tokës bujqësore fshatarëve të varfër nëpërmjet kolektivizimit dhe formimit të kooperativave fshatare, nëpërmjet integritimit të thjeshtë të punës deri te zhbërja e sistemit kooperativist dhe kthimi i kooperimit. Këto reforma janë realizuar gjatë periudhës së socializmit. Pas rënies së socializmit dhe luftës në Kosovë, vlerësohet se nga rreth 70,000 hektarë tokë në pronësi shoqërore, 42,000 hektarë janë planifikuar t'u kthehen pronarëve të mëparshëm. Një pjesë e kësaj prone u është shitur pronarëve të ndryshëm, ndërsa pjesa tjetër pritet të privatizohet. Nga regjistrimi në bujqësi i bërë në vitin 2014, sipërfaqja e tokës së shfrytëzuar bujqësore në Kosovë është 257,639 hektarë, ndërsa numri i familjeve bujqësore është 129,220, që do të thotë se sipërfaqja mesatare për një familje bujqësore është 1.99 hektarë. Sipas standardeve ndërkombëtare, sipërfaqja mesatare për një familje bujqësore sillet nga 80 deri 120 hektarë. Prandaj sipërfaqja mesatare e tokës së shfrytëzuar për familje bujqësore është e pamjaftueshme për zhvillimin e një bujqësie konkurruese. Me qëllim të rritjes së rendimenteve bujqësore, blegtorale, shpezëve etj., Ministria e Bujqësisë dhe e Zhvillimit Rural i ka stimuluar bujqit, blegtorët dhe kultivuesit e shpezëve nëpërmjet ndihmave financiare të drejtpërdrejta dhe indirekte. Megjithatë, pas luftës në Kosovë ende nuk janë ndërmarrë hapa konkretë për reforma të mirëfillta agrare (Selman Selmanaj)

REGJIMENTI "KOSOVA". Njësitushtarake gjatë qeverisë së Rexhep Mitrovicës (1943-1944). U formua në nëntor të vitit 1943, me mbështetje të ushtrisë gjermane dhe Xhafer Devës në cilësinë e ministrit të Brendshëm të Shqipërisë. Komandant i njësisë ishte Pajazit Boletini, nën komandën e të cilit ishin 1,500 ushtarë. Ushtarët ishin vullnetarë nga Mitrovica, Ferizaji, Gjilani, Vushtrria, Prishtina dhe Podujeva. Njësia ushtarake u formua me qëllim të luftimit të forcave të armatosura të Lëvizjes Antifashiste Nacionalçlirimtare (LANÇ) dhe fuqizimit të pushtetit qendror, të mbështetur nga gjermanët. Veprimtaria e regjimentit "Kosova" shtrihej në territorin shqiptar, me përqendrim të veçantë në Shqipërinë e Veriut dhe në Kosovë. Regjimenti u mbajt përgjegjës për ekzekutimin e shumë komunistëve e simpatizantëve të LANÇ-së, sidomos në Tiranë, Pejë etj. Me largimin e gjermanëve në nëntor të vitit 1944 shpërndahet dhe shuhet zyrtarisht ky regjiment. (Mrika Limani)

REGJISTRI BIZNESVE. Njëbazë etë dhënave për të gjitha bizneset e regjistruara dhe për aktivitetin e tyre në Kosovë tashmë funksionon në kuadër të Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve, në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe të Industrisë. Njëpërmjet këtij regjistri evidentohen aktivitetet biznesore sipas veprimtarive. Regjistri shërben si mjet për përgatitjen dhe koordinimin e hulumtimeve, si burim i informacionit për analizat statistikore të popullsisë dhe demografisë së bizneseve, për përdorimin e të dhënave administrative, për identifikimin dhe ndërtimin e njëjseve statistikore etj. Përveç se nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve, të dhënat merren edhe nga Administrata Tatimore e Kosovës. Në këto të dhëna përfshihen të dhënat identifikuese, siç janë të dhënat mbi veprimtarinë, fushën e aktivitetit, të dhënat mbi madhësinë, numrin e të punësuarve etj. Një version statistikor i regjistrimit të bizneseve publikohet po ashtu edhe nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, e cila publikon raporte tremujore, të quajtur "Repertori i Ndërmarrjeve në Kosovë", që po ashtu paraqet një burim të rëndësishëm të informatave. (Besnik Krasniqi)

REKA Blerim (1960-). Jurist, profesor universitar, publicist, diplomat. Lindi në Shkup, ku



BLERIM REKA

kreu shkollën fillore dhe të mesme, kurse Fakultetin Juridik dhe studimet e magjistraturës i kreu në Universitetin e Prishtinës. Në vitin 2002 u doktorua në të drejtën ndërkombëtare publike në programin e përbashkët doktoral ndërmjet Universitetit të Prishtinës (UP) dhe Universitetit të Gracit. Në vitet 2003-2005 bëri studime postdoktorale dhe specializime në disa universitete të njohura në Europë dhe SHBA. Ishte dekan i Fakultetit Juridik, dekan i Fakultetit të Shkencave Politike dhe rektor në Universitetin e Europës Juglindor në Tetovë. Në periudhën 2001-2006 ligjëroi marrëdhëniet ndërkombëtare në departamentin e shkencave politike të Universitetit të Prishtinës. Gjatë viteve 1983-2000 ishte gazetar, zëvendëskryeredaktor dhe drejtor i gazetës "Rilindja" në Prishtinë, anëtar i ekipit të ekspertëve të Kosovës për Konferencën e Rambujesë, kryesues i Këshillit Legjislativ të UNMIK-ut (1999-2004) dhe anëtar i komisionit të ekspertëve për hartimin e Kornizës Kushtetuese të Kosovës (2001), anëtar i Komisionit për Çështje Kushtetuese të Kuvendit të Maqedonisë dhe anëtar i ekipit të ekspertëve që hartoi strategjinë për integrim të Republikës së Maqedonisë në BE. Themeloi dhe drejtoi revistën juridike të Kosovës në gjuhën angleze "Kosova Law Review" (1996-2003) dhe ishte ambasador i Republikës së Maqedonisë në BE, në Bruksel (2006-2010). Është autor i një sërë studimesh, i monografive shkencore dhe teksteve universitare nga e drejta ndërkombëtare, e drejta e BE-së dhe marrëdhëniet ndërkombëtare: "E drejta e vetëvendosjes" (1996), "E drejta e Bashkimit Europian" (2000), "Gjeopolitika dhe teknika e zgjerimit të Bashkimit Europian" (2010) etj. (Arsim Sinani).

REKA Hamza (1925-2013). Mësimdhënës, veprimtar i kulturës. Lindi në Tetovë, ku kreu edhe shkollën fillore, ndërsa shkollën e mesme e filloi në Tetovë dhe e përfundoi në Normalen e Shkupit. Studimet i vazhdoi në degën e albanologjisë të Fakultetit Filologjik të Universitetit të Beogradit. Në periudhën 1946-1954 ishte mësues në fshatra të Kumanovës dhe të Shkupit. Ishte edhe edukator në konviktin

e shkollave të mesme në Shkup, drejtues i Teatrit të Kombësive në Shkup dhe lektor në dramën shqipe të këtij teatri. Në vitin 1960 zgjidhet profesor në Akademinë Pedagogjike në Shkup, ku punoi 30 vjet. Ligjëroi sintaksën, morfologjinë dhe metodikën e gjuhës shqipe. Ndërkohë, botoi edhe disa punime nga fusha e metodikës së gjuhës. Ishte bashkautor i disa teksteve shkollore për arsimin fillor shqip në Maqedoni. (Avzi Mustafa)

REKA Hazir (1961-). Fotoreporter. Lindi në Ferizaj. Filloi të punojë si fotograf profesionist në vitin 1984 në revistën “Bota e re”. Në vitin 1986 kaloi në të përjavshmen “Zëri i rinisë”.



HAZIR REKA

Gjatë viteve '80-'90 fotografitë e tij për zhvillimet në Kosovë u publikuan në revista dhe gazeta të ish-Jugosllvisë (“Mladina”, “Delo”, “Oslobodjenje”, “Vreme”, “Start” etj.) dhe në gazetatat e revistat prestigjioze botërore (“New York Times”, “Herald Tribune”, “Liberation”, “Time”, “Washington Post” etj.). Në vitin 1998 filloi të punojë për agjencinë e lajmeve “Reuters”. Me fotot e tij shënoi ngjarjet më të rëndësishme të dekadave të fundit në Kosovë, protestat, luftën, hyrjen e trupave të NATO-s, pavarësinë etj. Publikoi librin me fotografi “Ecja në terr - Kosova 1988-1990” dhe hapi ekspozita të fotografive në Kroaci, Zvicër, Francë, Arabi Saudite, Spanjë, Austri, Belgjikë etj. U nderua me çmime dhe mirënjohje të shumta brenda dhe jashtë vendit. (Nehat Islami)

REKALIU Xheladin (1948-1999). Veprimtar i lëvizjes për çlirimin e Kosovës. Lindi në Dobratin të Podujevës. Shkollën fillore e kreu në Kërpimëh, ndërsa shkollën e mesme në Prishtinë. Studimet i kreu në Shkollën e Lartë Teknike në Prishtinë. Si student ishte njëri ndër organizatorët e demonstratave të vitit 1968 në Prishtinë, për çka u dënua me 3 vjet burg, të cilin e vuajti në burgun famëkeq të Goli Otokut (Kroaci) nga dhjetori i vitit 1968 deri në qershor të vitit 1971. Më 1972 u punësua në KN “Ramiz Sadiku”. Deri në vitin 1981 u izolua dhe u burgos disa herë, ndërsa në vitin 1981 izolimi i tij zgjati gjashtë muaj e gjysmë. Xh. Rekaliu e përfshiu edhe izolimi i intelektualëve të Kosovës

më 1989. Me fillimin e pluralizmit politik në Kosovë, pas vitit 1989 vazhdoi angazhimin në jetën politike si anëtar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), ndërsa nga viti 1993 ishte i përfshirë edhe në udhëheqjen e degës së kësaj partie. Në fund të viteve '90 u angazhua për krijimin e strukturave të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Llap. Pas një sëmundje të rëndë vdiq në Podjevë. (Bajram Blaku)

REKUIZIMI. Ishte marrja me detyrim për nevojat ushtarake të tepricave të prodhimeve bujqësore. Nga mënyra si u administrua nga pushteti komunist, rekuizimi mori karakterin e një forme specifike të presionit serb mbi shqiptarët. Në emër të tepricave, organet e pushtetit ua merrnin me detyrim shqiptarëve edhe rezervat e fundit ushqimore. Vetëm në periudhën prill-maj të vitit 1945 në Kosovë u konfiskuan 3,760,000 kg drithë dhe 1,570,000 kg mish. Grumbullimi i tepricave ka zgjatur me vite. Vetëm gjatë vitit 1950 në tërë Kosovën u sekuestruan rreth 15,688, 016 kg grurë, 4,386,152 kg misër, 1,521,359 kg patate, 946,635 kg fasule, 2,363,623 kg luledielli etj. Forma e grumbullimit të tepricave përfshinte: drithin (grurë, misër, thekër, elb), mishin, patate, fasule, luledielli, ujemin nga mullinjtë, qepë, arra, mjaltë, qumësht, tëlyen, djathë. Teprica mblidhej edhe në sanë, kashtë, tallë, lesh etj. Rekuizimi në popull kujtohet si koha kur edhe me fshesë pastroheshin magjet, duke ua marrë kështu edhe rezervat e fundit të miellit familjeve shqiptare. Ndërsa ata që tentonin të fshehnin miellin apo bagëtinë, dënoheshin rëndë. Një situatë e ngjashme ishte në tërë viset shqiptare. Rekuizimi te shqiptarët në disa raste u bë edhe nën akuzën si “bashkëpunëtorë të fashizmit”. Ndërkaq, me ligjin e miratuar në vitin 1946, u bë shtetëzimi i mjeteve themelore të prodhimit. Në zbatim të tij u shtetëzuan minierat, bankat, fabrikat dhe ndërmarrjet e tjera të degëve të ndryshme të ekonomisë. Më vonë ligji u plotësua edhe për ndërmarrjet e vogla, dyqanet e zejtarëve dhe të tregtarëve. Shtetëzimi i një pjese të tokës ishte kryer me ligjin mbi reformën agrare. (Naim Musliu)

RELA V. Josip (1895-1966). Poet, prozator dhe dramaturg. Lindi në Arbënesh të Zarës (Kroaci). Kreu shkollën fillore në vendlindje, shkollën e mesme të mësuesisë në Shkollën Normale të Zarës. Punoi si mësues në vise të Dalmacisë, në Vuthaj dhe në fshatin e lindjes. Ishte drejtor i



JOSIP RELJA

Teatrit të Zarës. Shkroi poezi, tregime dhe vepra dramatike (komedi dhe drama). Në edicionin e revistës “Jeta e re”, më 1952 u botua drama e tij e parë “Martesa”. Më pas, po ky edicion ia botoi dramat: “Kungulli” (1953), “Nita” (1954), “Lundërza e Jozhës” (1962), “Zani i fëmiut” (1963), “Dila” (1965), “Dy drama” (1965), “Fisi i mallkuam” (1966), “Tallaset e dybëjes” (1966), dhe pas vdekjes: “Sot tetë ditë” (1968). Në vitin 1964, po nga “Jeta e re” u botua vëllimi “Vjersha”, ndërsa pas vdekjes, më 1968 dhe 1971, u botua vepra e tij e plotë në dy vëllime nga Redaksia e botimeve të “Rilindjes”. Kryevepra e tij, drama “Nita”, pati edhe disa ribotime, në Prishtinë, në Tiranë dhe, në botim dygjuhësh, arbërisht dhe kroatisht, në Zarë më 2014, si dhe u vendos në skena teatrore nga grupe amatore dhe profesioniste. (Isak Shema)

RELIEVI I LIBERIT. Pllakë votive kushtuar perëndisë së hardhisë së rrushit, verës dhe gëzimit (Liberit). U gjet rastësisht në Vrellë në potezin Lugu i Madh (2007) dhe gjendet në Muzeun e Kosovës. Është punuar nga mermeri vendor i bardhë (49.5 x 46 x 11-17 cm) dhe ka vetëm dy thyerje të vogla. Ka formë të lehtë piramidale me mbarim harkor. Në pjesën e parme janë skalitur katër figura mitologjike, të lidhura me grupin dionisiak (thiasos). Figurën qendrore e përbën Liberi romak (Dionisi) dhe të tjerët janë shoqëruesit e tij. Liberi, si figurë qendrore, është më e madhja dhe në relief të lartë. Është paraqitur me veshjen klamidë (nebrys) dhe çizme të thella. Dorën e djathtë e ka të ngritur mbi kokë, e cila është dëmtuar bashkë me tiparet e fytyrës, ndërsa të majtën e ka të hedhur rreth supeve të Satirit lakuriq. Në anën tjetër gjenden dy figura të tjera, me koka të kthyer nga perëndia: Pani i ulur mbi një shkëmb, duke i rënë fyellit të barinjve (syrinx) dhe Sileni, edukator i Dionisit, i cili qëndron në këmbë dhe me një gjësend në duar drejtuar Liberit. Relievi, i cili paraqet çast gëzimi dhe hareje, është punuar me mjaft kujdes nga dora e një mjeshtri të talentuar, sipas të gjitha gjasave shëtitës, i cili, bazuar në gurin vendor, e punoi në vend diku rreth gjysmës së dytë të shek. II apo gjysmës së parë të shek. III.

Rëndësia e relievit qëndron në faktin se në Kosovë paraqitet për herë të parë, përderisa dedikimet Dionisit/Liberit janë të pranishme në pjesët e tjera të Dardanisë. Ky kompozicion paraqet ekzemplar unik në Dardani dhe në të nderohej një perëndi e vjetër epihorike me veti të afërta me Liberin/Dionisin. (Exhlale Dobruna-Salihu)

REMESIANA. Vendbanim i periudhës antike, stacion rrugor në kuadër të rrugës Naissus-Serdica. Shërbeu si pikë ndarëse e rrugëve që shpinin nga jugu në drejtim të zonave me miniera të Blasinës dhe Pautalijas dhe asaj nga veriu që shkonte përgjatë luginës së Timokut dhe lidhej me rrugën Naissus-Ratiaria. Ishte dhe pikë kalimi nga territori i Dardanisë dhe Mezisë së Epërme në atë të Trakisë. Statusi administrativ i Remesianës, që gjendej në kuadër të municipium Naisit është vështirë të përcaktohet. Që nga shek. IV njihej edhe si qendër e rëndësishme kishtare. Në burimet kishtare njihet sidomos si vendlindja e peshkopit Niketë Dardanit (366-414). Sipas mbetjeve arkeologjike, vendbanimi është lokalizuar në Bela Palanka (Serbi). (Emine Kalaja-Hajdari)

REMITANCAT. Trasferet e mjeteve financiare që bën një punëtor emigrant për familjen apo të afërmit e tij në vendin e tij të origjinës. Këto transfere paraqesin burimin e dytë më të rëndësishëm të ndihmës financiare për vendet në zhvillim. Sipas Bankës Botërore, vendet në zhvillim më 2013 kanë pranuar 410 miliardë dollarë amerikanë, me tendencë të rritjes në vitet në vijim. Për disa vende, siç është Taxhikistani, remitancat janë sa gjysma e brutoproduktit vendor. Kështu, remitancat luajnë rol të rëndësishëm në zvogëlimin e varfërisë, financimin e zhvillimit dhe në aspekte të tjera. Ato ndikojnë në krijimin e kapitalit njerëzor, pasi familjet mund të financojnë arsimimin e të rinjve, të cilët në kushte të tjera nuk do të kishin vijuar arsimin. Remitancat ndikojnë edhe në fuqinë punëtore të vendit të origjinës së emigracionit, duke rritur pagën e rezervuar dhe papunësinë. Remitancat janë shumë të rëndësishme për ekonominë e Kosovës. Sipas Bankës Qendrore të Kosovës, vlera e remitancave të pranuar gjatë vitit 2014 ka qenë 693,7 milionë euro, me një rritje prej 11% krahasuar me një vit më parë. Shumica e

remitancave vijnë nga Gjermania dhe Zvicra, ku janë të koncentruar shumica e emigrantëve kosovarë. Pjesa më e madhe e remitancave përdoren për qëllime konsumi. (Avdullah Hoti)

REMNIKU Hasan (1913-1951). Luftëtar anti-komunist dhe kundër pushtetit jugosllav në Kosovë. Lindi në Remnik të Vitisë. Deri në fillimin e Luftës së Dytë Botërore merrej me bujqësi. Me 1941, me ndarjen e zonave të pushtimit në atë bullgare dhe italiane, Remniku dhe shumë fshatra të Karadakut mbetën në zonën bullgare. Në shtator të vitit 1941, H. Remniku i shpëton një rrethimi bullgar dhe largohet në Partesh, që i takonte zonës italiane. Një kohë punoi si polic dhe truprojtë e kryetarit të Parteshit, Ramiz Cërnicsës. Pas masakrës që bënë forcat bullgare dhe popullsia lokale serbe në Remnik, H. Remniku i sulmoi këto forca. Aksionet e këtilla i vazhdoi edhe gjatë viteve 1942 dhe 1943. Mori pjesë edhe në luftën e Preshevës më 1944 kundër forcave jugosllave. Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore dhe hyrjes së forcave ushtarake jugosllave dhe dështimit të kryengritjes, H. Remniku dorëzohet dhe burgoset. Pas liritimit bashkëpunoi me Lëvizjen Nacional-Demokratike Shqiptare (LNDSH). Ndhimoi në formimin e komiteteve të LNDSH-së në Anamoravë. Pas zbulimit të veprimtarisë së LNDSH-së (1947) dhe burgosjes së anëtarëve të saj në Shkup, Gjilan dhe Ferizaj, kaloi në ilegalitet. Gjente strehë nëpër fshatrat e Anamoravës, si në Remnik, Lubishtë, Smirë, Livoç i Epërm, Bresalc, Gadish, Ponesh etj. Më 6 tetor 1951, me grupin e tij, nisët për në Shqipëri. Pasi kaloi lumin Lumbardh afër Prizrenit, më 10 tetor 1951 bien në pritë të forcave serbe dhe vritet me shokët e tij. Pas vrasjes trupat e tyre u ekspozuan në Viti dhe Gjilan. Varri nuk i dihet. (Naim Musliu)

RENDIQ-MIOÇEVIQ (Rendić-Miočević) Duje (1916-1993). Arkeolog kroat, ilirolog akademik. Lindi në Split, ku kreu edhe gjimnazin klasik, ndërsa studimet për filologji klasike dhe arkeologji i kreu në Universitetin e Zagrebit, ku dhe doktoroi në temën mbi onomastikën ilire dhe mbishkrimet latine të Dalmacisë. Ishte drejtor i Muzeut Arkeologjik në Split dhe profesor i rregullt në katedrën e arkeologjisë në Universitetin e Zagrebit, ku ligjëroi arkeologjinë klasike, provinciale dhe

të hershme krishtere, si dhe epigrafinë dhe numizmatikën (1961-1983). Ishte edhe drejtor i Muzeut Arkeologjik të Zagrebit (1966-1979) dhe udhëheqës i sektorit të numizmatikës, anëtar i Akademisë Jugosllave të Shkencave dhe të Arteve (1977). Veprimtaria e tij shkencore në ilirologji është e gjerë dhe është përmbledhur në veprën kapitale “Ilirët dhe bota antike” (1989). Meritë të veçantë ka për studimet e onomastikës së territorit ilir dhe të numizmatikës, me theks të veçantë të monedhave të mbretërve ilirë (Monunit, Gentit, Baleut). Trajtoi dhe artin ilir, sidomos monumentet e kultit dhe ato mbivarrore. (Exhlale Dobruna-Saliu)

REPUBLIKA E RAGUZËS. Për vazhdimësinë e jetës në arealin e sotëm të komunës së Dubrovnikut dëshmojnë gjurmët e zbuluara nga parahistoria, periudha ilire, romake dhe mesjetare. Sipas burimeve historike qyteti nisi të zhvillohet nga fundi i antikitetit dhe në fillimet e mesjetës (IV-VI), në gadishullin shkëmbor Laus, Lave, që më vonë nisi të quhet *castellum*. Me emrin *Epitarium id est Ragusium* përmendet për herë të parë të *Cosmographia e Ravennatis* Anonymi (shek. VII-VIII), i cili theksonte se Raguzë ishte trashëgimtare e Epidaurit të lashtë. Por, lajmet e para të besueshme për këtë qendër i kemi nga gjysma parë e shek. X nga K. Porfirogjeneti. Burimet relevante e përmendin dendur gjatë shek. X-XI, përkatësisht në vitin 1022, kur ishte ngritur në rangun e argjipeshkvisë me seli mitropolit, e cila udhëhiqte ipeshkvitë sufragane të Kotorrit, Tivarit dhe Ulqinit. Raguzë për një kohë kishte pranuar pushtetin e Bizantit, për të rënë më vonë nën atë të Venedikut dhe të Hungarisë (1358). Komuna autonome e Raguzës përmendet për herë të parë më 1181 (*Comunitas Ragusina*). Komuna kishte Statutin (1272), arkivin dhe bibliotekën publike, si dhe arkivin dhe bibliotekën kishtarë, pa lëndën e të cilave nuk do të mund të shkruhej historia mesjetare e Kosovës. Duke pasur të gjitha atributet shtetërore (territorin, stemën, flamurin, si dhe sistemin monetar), nga gjysma e dytë e shek. XIV nisi të quhet Republika e Raguzës (*Respublica Ragusina*). Si e tillë, ajo u bëri ballë sulmeve osmane, për të rënë më vonë nën francezët e Napoleonit (1808). (Jahja Drançolli)

REPUBLIKA E VENEDIKUT. Shtet që shtrihet në territorin e sotëm të Italisë Verilindore dhe në një pjesë të madhe të Adriatikut dhe Mesdheut. Baza e Republikës së ardhshme ishte qyteti i Venedikut, i themeluar nga popullata e migruar nga qytetet Aquileia, Padova dhe Altinum, të cilët kishin ikur nga pushtimet e hunëve, të longobardëve dhe të popujve të tjerë barbarë. Qyteti u zhvillua nga tregtia me Levantin, para së gjithash me Konstandinopojën. Republika kishte krijuar një monopol tregtar në tërë Mesdheun, duke siguruar bazë të fuqishme materiale për ekspansionin territorial. Në kohën e zhvillimit më të madh, Venediku pati nën pushtet pjesë të sotme të Italisë, Sllovenisë, Dalmacisë, Malit të Zi, Shqipërisë, Greqisë, Qipros dhe ndonjë ishulli të Mesdheut. Kjo republikë luajti një rol të rëndësishëm edhe në kryqëzata, veçanërisht në Kryqëzatën IV, në transportimin e luftëtareve me anije dhe organizimin e tyre. Nga kjo ndërmarrje, Republika pati përfitime shumë të mëdha. Që nga Kryqëzata IV, Venediku kishte shtruar si synim pushtimin e qyteteve bregdetare shqiptare, si zona të interesit të veçantë për politikën dhe ekonominë e tyre. Kështu, në fund të shek. XIV dhe gjatë gjysmës së parë të shek. XV, Venediku kishte pushtuar me radhë Durrësin, Shkodrën, Lezhën, Drishtin, Danjën, Shasin, Ulqinin, Tivarin, Budvën, Perastin, Risanin e Kotorrin. Si pasojë e këtyre pushtimeve, kjo pjesë e tokave të Shqipërisë së Veriut mori emrin “Albania Veneta”, dhe shtrihet nga Lezha deri përtej Grykës së Kotorrit, në Castelnuovo (Herceg Novi). Ndërmjet viteve 1392 e 1396, emërtimi “Shqipëri venedikase” i zotërimeve të Republikës së Shën Markut në bregun lindor të Adriatikut zinte vend edhe në dokumentet zyrtare.

Republika e Venedikut, përkatësisht venedikasit, sidomos gjatë shek. XIV dhe gjysmës së parë të shek. XV ishin të pranishëm dhe aktivë në qendrat tregtare dhe zejtare të Kosovës. Ata tregonin në Trepçë, Novobërdë, Prizren, Pejë, Prishtinë etj. Republika e Venedikut e arriti kulmin e zhvillimit ekonomik, politik e kulturor gjatë shek. XV, kur kishte më shumë se 200,000 banorë dhe ishte qendër e tregtisë botërore. Rënia e Republikës së Venedikut filloi me pushtimin osman të Konstandinopojës dhe me zbulimin e rrugëve të reja detare, veçmas të Amerikës. Megjithatë, edhe më tej, Republika

e Venedikut mbeti si qendër e rëndësishme kulturore, me ndikim të madh në arkitekturën, letërsinë dhe në artin evropian. Republika e humbi pavarësinë me rastin e pushtimeve të Napoleonit (12 maj 1797). (Muhamet Mala)

RESTELICA. Fshat i madh në komunën e Dragashit, 24 km në jug të qytetit. Shtrihet në trekufirin Kosovë-Shqipëri-Maqedoni, në lartësi mbidetare 1,400 m. Është vendbanim i tipit të dendur, me sipërfaqe 84.7 km². Si vendbanim përmendet në defterin e sanxhakut të Prizrenit të vitit 1530. Një numër i konsiderueshëm i banorëve emigroi brenda dhe jashtë Kosovës. Megjithatë, popullsia e fshatit shënoi rritje të vazhdueshme. Derisa në vitin 1948 kishte 1,393 banorë, në vitin 2011 u regjistruan 4,698 banorë. Popullsia merret me blegtori. Kultivohen gjedhet e imëta dhe bëhet përpunimi i qumështit dhe djathit. Përveç blegtorisë, fshati merret edhe me bletari, turizëm, mbledhjen e frutave malore, bimëve mjekuese, zeytari etj. Një pjesë e konsiderueshme e territorit të fshatit ndodhet brenda kufijve të Parkut Kombëtar “Mali Sharr”. Ka shkollën 9-vjeçare, stacionin shëndetësor, disa dyqane tregtare etj. (Hasim Kryeziu)

RESULA. Fortifikatë bizantine e ngritur në fshatin Pidiç (afër Zhegrës, Gjilan, në Malësinë e Karadakut), e cila ruan shtresa të mëhershme të njohura së paku nga shek. VII p.e.s. Fortifikata quhet në popull Kalaja e Rimit dhe më shpesh vetëm Resula. Fortifikata që dominon mbi fshatin e afërt, është ngritur në malin shkëmbor dhe shoqërohet nga shpellat në pjesën e shkëmbit, për të mbrojtur zonat e pasura me xehe të kësaj ane. Në anën juglindore dhe perëndimore të fortifikatës ndodheshin lagjet e banuara, ku janë të dukshme pjesë të shumta të tjegullave, fragmente të qeramikës dhe silikse sporadike. Fortifikata është ngritur mbi kodrinën me lartësi mbidetare rreth 740 m. Nga tri anët, duke mos e llogaritur anën veriore, fortifikata ka pasur mbrojtje solide. Kodrinën e shoqërojnë edhe tri shpella, të cilat ndodheshin në pjesët shkëmbore të kalasë, dy prej të cilave sigurojnë kishin shërbyer si kthina-strehimore për banorët që jetonin në fortifikatë. Hyrja në fortifikatë ishte vetëm nga ana veriore, ku edhe tani ruhen gjurmë të rrugës së dikurshme, që shpinte brenda saj. Ashtu si në shumicën e monumenteve të

tilla, edhe në këtë fortifikatë vërehen gërmime klandestine, sidomos në dy kullat kryesore, kështu që dëmtimet në monument janë serioze. Në pjesën e poshtme, nën fortifikatë, janë zbuluar varreza të vjetra, skelete njerëzish, mure të banesave me lidhës gëlqereje, qypa, tjegulla të trasha etj. (Faik Sahiti)

RESURSET NATYRORE. Janë faktor i rëndësishëm i prodhimit dhe i zhvillimit ekonomik. Konsiderohen edhe si pasuri kombëtare, që përshijnë tokën, pyjet, mineralet, ujin etj. Janë vlera materiale të siguruara nga toka (natyra), të cilat njerëzit mund t'i përdorin për t'i konsumuar ose për të prodhuar produkte më komplekse, nëpërmjet nxjerrjes-ekstraktimit, përpunimit dhe fisnikërimit të tyre. Burimet natyrore zakonisht ndahen në burime të përtëritshme dhe burime të papërtëritshme. Burimet e përtëritshme përfshijnë ujin, energjinë diellore dhe drurin. Këto burime mund të përdoren, por nuk harxhohen, ose mund të ripërtëriten. Burimet e papërtëritshme kanë të bëjnë me derivatet e naftës dhe mineralet. Pas konsumimit ato nuk mund të ripërtëriten dhe të zëvendësohen, por në një masë të vogël mund të kompensohen përmes riciklimit.

Kosova është e pasur me minerale, në veçanti me linjtë dhe me metale, si: plumb, zink, ferronikel, magnez etj. Sipas një vlerësimi të bërë në vitin 1985 në një plan strategjik për zhvillimin e Kosovës për periudhën 1985-2000, nga Enti për Plan dhe Zhvillim të Kosovës, është vlerësuar se nga burimet minerare energjetike Kosova ka 12 miliardë tonë linjtë dhe 1 milion tonë naftë. Ndërkaq, nga burimet minerare metalike, Kosova ka 5 milionë tonë xehe të boksitit, 75 milionë tonë xehe të plumbit dhe zinkut, 40 milionë tonë xehe të nikelit, 5 milionë tonë xehe të hekurit, 6 milionë tonë xehe të manganit etj. Nga burimet minerare jometalike është vlerësuar se Kosova ka 30 milionë tonë kuarc dhe rërë kuarci, 17 milionë tonë magnezit, 8 milionë tonë argjilë të padjegshme, 20 milionë tonë xehe azbesti, 120 milionë tonë bentonit, 175 milionë tonë lapor çimentoje etj. Pra, Kosova mund të konsiderohet relativisht e pasur dhe ka përparësi në krahasim me vendet e rajonit. Burimet natyrore, si tënëgjilli dhe disa minerale të tjera, mund të jenë faktorë kyç për krijimin e një qëndrueshmërie ekonomike, për tërheqjen e investimeve të jashtme të

drejtpërdrejta dhe mund të sigurojnë një rritje ekonomike nëse ato shoqërohen me teknologji të avancuara dhe me shërbime nga fusha e hulumtimeve zhvillimore, nëse aranzhmanet për eksploatimin dhe procesimin e tyre valorizojnë interesin publik, interesin e investitorit dhe interesin e komunitetit. (Muhamet Mustafa)

RESHITAJ Ramadan (1955-). Gazetar. Lindi në Samadrexhë të Suharekës. Aty kreu shkollën fillore, gjimnazin në Suharekë, ndërsa studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe i kreu në Prishtinë. Punën si gazetar e filloi në Radio Prishtinë (1976). Ishte kryeredaktor i gazetës së kolektivitetit të "Ballkanit" të Suharekës, pastaj gazetar-redaktor në gazetën "Rilindja". Pas emigrimit në Suedi (1992), bashkëpunoi me emisionin në gjuhën shqipe të Radio-Suedisë. Ishte njëri nga themeluesit dhe kryeredaktor i revistës "Besa", që u botua nga Unionit i Shoqatave Shqiptare në Suedi. Është autor i librave letrarë dhe i monografisë "Shkolla shqipe në Suedi" (2011). Jeton dhe krijon në Malmo të Suedisë. (Gazmend Syla)

RESHITAJ Refki (1953-). Gazetar. Lindi në fshatin Samadrexhë të Suharekës. Mësimet e fillores i kreu në vendlindje, shkollën e mesme të muzikës në Prizren, ndërsa studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Prishtinës. Si fëmijë bashkëpunoi me "Rilindjen për fëmijë" dhe revistat "Pionieri", "Shëndeti" e "Flaka e vëllazërimit", e më pas, si nxënës i shkollës së mesme edhe me "Zërin e rinisë" dhe Radio-Prishtinën. Më 1977 filloi punën në gazetën "Rilindja", korrespondent nga Suhareka dhe Prizreni. Nga këto dy qytete raportoi rreth 30 vjet, edhe për "Bujkun", "Zërin" dhe medie të tjera. Pas lufte themeloi në Suharekë radion private Radio-Theranda dhe punoi si redaktor përgjegjës dhe kryeredaktor në TV-Prizreni. (Gazmend Syla)

RESHITI Nail (1962-). Ekonomist, profesor universitar. Lindi në Resne të Maqedonisë, shkollimin bazë e mori në vendlindje dhe në Shkup, ndërsa u diplomua në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës (1985). Studimet pasuniversitare i ndoqi në Zagreb, kurse studimet e doktoratës i përfundoi në Tiranë (1996). Filloi të punojë më 1988 në



NAIL RESHITI

Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës, ku vazhdon të ligjërojë lëndët për marketingun dhe menaxhimin e marketingut. Ligjëroi edhe në universitete të tjera publike dhe private. Ka bërë disa udhëtime studimore jashtë vendit, në Europë dhe në SHBA. Gjatë viteve 2004-2005 punoi edhe në Ministrinë e Energjisë dhe të Minierave, si drejtor i departamentit për zhvillim dhe strategji. Është autor i teksteve universitare "Promocioni, reklama dhe shitja personale" dhe "Kërkimet e tregut", si dhe bashkautor i teksteve "Hyrje në ekonomi", "Bazat e marketingut" etj. Mori pjesë në konferenca të ndryshme dhe botoi disa punime shkencore. (Selman Selmanaj)

REVISTA "BULETINI I FAKULTETIT FILOZOFIK". Revistë shkencore e Fakultetit Filozofik të Prishtinës, që nisi botimin në vitin 1963, si botim i Universitetit të Beogradit, pjesë e të cilit ishte Fakulteti Filozofik i Prishtinës deri në vitin 1970. Revista mbante emrin "Buletin i punimeve shkencore të Fakultetit Filozofik të Prishtinës". Deri në vitin 1969 dolën 6 numra. Nga viti 1970 deri në vitin 1980, ku si botues figuron Universiteti i Prishtinës dolën edhe 8 numra. Nga viti 1980 deri në vitin 1990, ku si botues figuron Universiteti i Kosovës, dolën 4 numra, ndërsa nga viti 1991, në kohën e sistemit paralel të arsimit shqip dhe më pas, deri më sot, ku si botues figuron Universiteti i Prishtinës, dolën edhe 8 numra. Deri në largimin e dhunshëm të kuadrit mësimor shqiptar nga Universiteti i Prishtinës, kjo revistë botohej në dy gjuhë, në gjuhën shqipe dhe serbokroate. Nga viti 1970 në revistë u botuan kontribute shkencore të të gjitha fushave, ndërkaq nga viti 1989 botoheshin vetëm kontributet shkencore të mësimdhënësve të katedrave të shkencave humane. Revista vazhdon të botohet me ndërprerje. (Gazmend Rizaj)

REVISTA "BULETINI I MUZEUT TË KOSOVËS". Revistë e Muzeut të Kosovës. Nisi të botohet në vitin 1956 dhe numri i fundit i saj u botua në vitin 1988 (XV-XVI). Revista botoi studime dhe artikuj, kontribute, vështrime, kritika dhe recensionet nga arke-

ologjia, etnologjia, etnomuzikologjia, historia, natyra, muzeologjia, onomastika, letërsia dhe trashëgimia kulturore e Kosovës. Punimet e studiuesve nga Kosova dhe jashtë saj janë botuar në gjuhën shqipe dhe serbokroate, me abstrakte në gjuhën shqipe, serbokroate, angleze, gjermane dhe frënge. "Buletini" është shkëmbyer dhe shpërndarë në 130 institucione të Jugosllavisë dhe në 161 institucione të botës. Është revistë e parë shkencore me përmbajtje shumëdisiplinare. (Kemajl Luci)

REVISTA "DITURIA ISLAME". Revistë e përnuajshme fetare-kulturore-shkencore, organ zyrtar i Kryesisë së Bashkësisë Islame. Numri i parë i revistës doli në qershor të vitit 1986 si revistë tremujore dhe vazhdoi deri më 1990, ndërsa që atë vit dhe prapa del çdo muaj. Që nga fillimi, revista ka trajtuar tema profesionale nga fushat e shkencave islame, drejtësi islame, filozofi, histori islame etj., pastaj tema nga kultura, tradita, trashëgimia dhe historia e vendit, si dhe kronika e informata nga terreni, kryesisht për aktivitetin e Bashkësisë Islame të Kosovës. Një rol të rëndësishëm revista ka luajtur gjatë viteve '90, kur u shndërrua në tribunë me pjesëmarrje të gjerë bashkëpunëtorësh, sidomos pas mbyllës së "Rilindjes" dhe botimeve të saj. Misioni i revistës "Ditura islame" ka qenë dhe vazhdon të jetë hapja e rrugës dhe krijimi i hapësirës së duhur për emancipimin, përparimin dhe edukimin e drejtë në aspektin shpirtëror, kulturore dhe moral. E konceptuar fillimisht si revistë fetare islame, mision të cilin e ka parësor, ajo nuk ngeli vetëm në kuadër të një reviste thjesht fetare, por me kohës u shndërrua në një tribunë të mendimit fetar, filozofik, kulturor dhe atdhetar, duke arritur të afrojë rreth vetes pena të njohura sidomos për disiplinat fetare. Selia e redaksisë është në Prishtinë dhe ajo ka portalin e saj: www.dituriaislame.com. (Ramadan Shkodra)

REVISTA "DITURIA". Revistë shkencore, numri i parë i së cilës doli në vitin 1971. Filloi të botohej si revistë shkencore e studentëve të Kosovës, në kuadër të gazetës së studentëve "Bota e re". Në periudhën 1971-1975 revista botoi punime nga fushat e ndryshme, përmbajtja e të cilëve tërhoqi vëmendjen opinionit dhe të qarqeve shkencore dhe intelektuale të kohës. Po në ato vite, kryesisht për arsye politike, botimi

i revistës "Dituria" u ndërpre. Në vitin 1980 rifilloi botimi i saj në kuadër të revistës "Zëri i rinisë", përkatësisht, si organ i Lidhjes së Rinisë Socialiste të Kosovës, meqë Lidhja e Studentëve u suspendua. Edhe rifillimi i botimit u përcoll me vështirësi politike, të cilat bënë që pas një periudhe (1981-1987) dalja e revistës "Dituria" të ndërpritej përfundimisht. Kryeredaktorë të revistës "Dituria" kanë qenë: Hivzi Islmaj, Ajri Begu dhe Agim Zogaj. (Agim Zogaj)

REVISTA "DRITA". E përmuajshme fetare-kulturore, revistë e Kishës Katolike në Kosovë. U themelua në vitin 1970. Numri i parë doli për Pashkët e të njëjtit vit, me format A4, me gjithsej 8 faqe. Bashkëpunëtorë të saj ishin priftërinjtë e njohur, si imzot Nikollë Mini, dom Gaspër Gjini, dom Damjan Kurti, dom Zef Gashi etj. Gjatë viteve 1970-1974 "Drita" u shtyp në Prizren, më pas në Sarajevë dhe më vonë në Zagreb. Më pas botimi i revistës u ndërpre, por rifilloi prapë në vitin 2008. Shkroi për aktivitetet e kishës në Kosovë, për kishën botërore, për kulturën e krishterë dhe shqiptare, për ngjarjet në shoqërinë kosovare dhe fenomenet e ndryshme të kohës. Aktualisht selia e saj është në Prishtinë, në rezidencën e Ipeshkvisë së Kosovës. Ajo ka edhe portalin online. Kryeredaktor i "Dritës" për shumë vjet ishte dom Lush Gjergji, ndërkaq tani është dom Fatmir Koliqi. (Ndue Ukaj)

REVISTA "E DREJTA". Revistë për çështje juridike dhe shoqërore, që botohet nga Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës. Është revistë periodike me karakter shkencor, ku publikohen punimet me autorë vendorë e ndërkombëtarë. Në fillim doli si revistë juridike-shkencore e Shoqatës së Juristëve të Kosovës "E drejta-Pravo", të cilën deri në vitin 1991 e botonte Instituti i Fakultetit Juridik, në dy gjuhë, shqip dhe serbokroatisht. Pas vendosjes së masave të dhunshme në Universitetin e Prishtinës, u ndërpre botimi i revistës për katër vjet. Këshilli Mësimor-Shkencor i Fakultetit Juridik më 1994 vendosi të rifillonte botimi i revistës vetëm në gjuhën shqipe, duke nxjerrë numrin e parë në fillim të vitit 1995. Revista "E drejta" botohet çdo tre muaj. (Nerxhivane G. Dauti)

REVISTA "EDUKATA ISLAME". Revistë shkencore-kulturore islame, e themeluar në vitin 1971, si e para revistë islame në gjuhën

shqipe në Kosovë. Botues i revistës ishte Shoqata e Ylemave, e cila drejtohej nga myderrizi Sherif Ahmeti, iniciator i botimit të revistës dhe kryeredaktori i parë i saj. Pas shuarjes së Shoqatës së Ylemave më 1997, botimin e revistës e mori përsipër kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës. Me botimin e kësaj reviste në Kosovë zuri fill publicistika dhe shtypit periodik islam në gjuhën shqipe. Që nga fillimi i daljes e deri më sot në revistë janë trajtuar tema të ndryshme të shkencave islame, të historisë islame, të apologjetikës, të kulturës, të letërsisë islame dhe të shkencave shoqërore në përgjithësi. Kontributin më të madh në ngritjen e revistës e kanë dhënë themeluesit e saj: Sherif Ahmeti, Hajrullah Hoxha, Avni Aliu, Bajrush Ahmeti etj. dhe bashkëpunëtorë të shumtë nga Kosova, Maqedonia dhe tash së fundi edhe nga Shqipëria. "Edukata islame" është revista islame më jetëgjatë në trojet shqiptare. (Qemajl Morina)

REVISTA "EKONOMIA". Revistë e Entit respektivisht Institutit për Kërkime Ekonomike të Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Prishtinës. Numri i parë i kësaj reviste për çështje të teorisë dhe praktikës ekonomike u botua në vitin 1973. Në fillim revista u botua nga Enti për Kërkime Ekonomike i Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Prishtinës, ndërsa më vonë, me themelimin e Institutit për Kërkime Ekonomike, botimi i saj kaloi në kompetencë të këtij instituti. Revista kryesisht u fokusua në zhvillimin e mendimit shkencor dhe profesional dhe në trajtimin e problemeve ekonomike dhe shoqërore të kohës. Pas suprimimit të autonomisë së Kosovës dhe ndërprerjes së punës së institucioneve, janë botuar edhe katër numra të revistës, më pas pushoi të botohej. (Selman Selmanaj)

REVISTA "FATOSI". Revistë letrare për fëmijë, që u botua në Shkup në periudhën (1955-2004). Nisi të botohet në kuadër të Shtëpisë Botuese "Detska radost" e Shkupit, pastaj në kuadër të njësisë punuese "Flaka e vëllazërimit". Si revistë me fizionomi të përshtatshme për moshën së cilës i dedikohej, "Fatosi" dha kontribut të madh në nxitjen e krijimtarisë letrare të të vegjëlve, por edhe të shkrimtarëve të afirmuar. E themeloi dhe një kohë të gjatë e drejtoi poeti Mehmedali Hoxha. Në faqet e saj bënë hapat e parë shumë pena të

njohura të letërsisë sonë për fëmijë. Përveç për krijime letrare, pati rubrika edhe për informim dhe zbavitjen e fëmijëve. Pushoi së botuari në mungesë të mjeteve financiare. (Xhevat Sylaj)


REVISTA "FILOLOGJIA". Organ i Fakultetit të Filologjisë të Universitetit të Prishtinës, me artikuj nga fusha e gjuhësisë dhe e letërsisë. Për herë të parë u botua më 1996. Kryeredaktor i saj i parë ishte Zejnullah Rrahmani. Kjo revistë shkencore trajton probleme të gjuhësisë dhe të letërsisë. Në numrat e saj trajtohen probleme teorike të gjuhës dhe të letërsisë, probleme praktike të gjuhës standarde shqipe, aspekte të sintaksës dhe të morfologjisë, çështje të onomastikës, ndikimet e gjuhëve të huaja në shqipen. Vend të veçantë zënë edhe studimet për emrat e njohur të gjuhësisë shqiptare, si: E. Çabej, S. Riza, I. Ajeti etj. Rubrikat e saj standarde janë: studime, artikuj, materiale, mendime, recensionet. Punimet shoqërohen me një rezymë në një gjuhë të huaj. Botohet një herë në vit. (Abdurrahim Maxhuni)

REVISTA "FJALA". Revistë e përdyjavshme kulture, arti e letërsie. Numri i parë i saj doli në Prishtinë, më 5 shkurt 1968. Kryeredaktor i parë i saj ishte publicisti Ali Sutaj (1937-1989). Ka botuar letërsi bashkëkohore, letërsi të traditës dhe të përkthyer. Po ashtu ka botuar edhe intervista me krijues, kronikën për ngjarjet kryesore kulturore të kohës, shkrime për çështje kulturore, për teatër, muzikë dhe arte figurative. Më 1 prill të vitit 1981, nga pushteti i asaj kohe u burgos Sabit Rrustemi, autori i tregimit "Nën maskën e mysafirëve" dhe kryeredaktori i revistës Sabedin Haliti. Gjatë viteve '90 janë botuar edhe disa tituj librash në kuadër të edicionit të kësaj reviste. Për shkaqe financiare, që nga viti 2005 revista "Fjala" nuk botohet më. (Ragip Sylaj)

REVISTA "FRYMA E FILOZOFISË". Revistë me karakter filozofik, e themeluar në vitin 1999 nga Kristë K. Shtufi, në kuadër të Unionit austriako-shqiptar "Bashkimi", me seli në Grac të Austrisë. Revista shënoi nismën e përhapjes së rrymës së filozofisë analitike në vendet shqipfolëse. Synimi i saj ishte sidomos përkthimi në shqip dhe publikimi i artikujve klasikë nga fusha e logjikës dhe e filozofisë analitike. Revista ka përkthyer dhe botuar shkrime të emrave të njohur të këtij drejtimi të

filozofisë. U botua deri në vitin 2001. (Albulena Alushaj)

REVISTA "GJUHA SHQIPE". Revistë shkencore gjuhësore, e botuar nga Instituti Albanologjik i Prishtinës. Numri i parë doli nga shtypi më 1982. Botimi i saj tri herë në vit vazhdoi



deri në vitin 1990. Më 1997 rinis botimi i revistës po nga Instituti Albanologjik, kësaj radhe me nga dy numra, për t'u ndërprerë sërisht më 1999 për shkak të luftës në Kosovë. Në vitin 2000 rifilloi botimi me nga tre numra. Kjo revistë trajton çështje të gjuhës letrare shqipe, të normës letrare dhe të kulturës së gjuhës. Boton studime, artikuj, diskutime, kritikë, materiale leksikore, bibliografi dhe kronika shkencore. (Abdurrahim Maxhuni)

REVISTA "GJUHA-DIL-JEZIK". Revistë e Shoqatës së Gjuhësisë Aplikative të Kosovës, në kuadër të politikave të Lidhjes së Komunistëve të Kosovës pas vitit 1981. U botua më 1985, 1-2. Qëllimi i revistës, i botuar në tri gjuhë: shqip, serbokroatisht dhe turqisht, ishte shprehja e barazisë që ndiqej në lëmin e përdorimit të gjuhëve në Krahinën Socialiste Autonome të Kosovës, në Republikën Socialiste të Serbisë dhe në Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë. Revista ishte e strukturuar në studime e artikuj, tekste të zgjedhura, recensionet e prezantime, kronika dhe bibliografi. Kryeredaktor dhe redaktor përgjegjës ishte Hasan Kelmendi. (Abdurrahim Maxhuni)

REVISTA "GJURMIME ALBANOLOGJIKE". Revistë shkencore e Institutit Albanologjik të Prishtinës. Ka tri seri: të shkencave filologjike, të folklorit dhe etnologjisë si dhe të shkencave historike. Dy të fundit u ndanë më 1971. Është vazhdim i revistës "Gjurmime albanologjike - Albanološka istraživanja", themeluar në vitin 1960, që u botua nga katedra e albanologjisë e Fakultetit Filozofik të Prishtinës. Botimi i parë doli në ndjekje të idesë së komisioneve të gjuhës dhe të letërsisë shqipe, historisë dhe folklorit të Këshillit Krahinor të Arsimit. Me titullin "Gjurmime albanologjike - Albanološka istraživanja" dolën vetëm tre numra: më 1962,



1965 dhe 1966. Në numrin 1/1968 ishte shënuar viti VII/ I dhe thuhej se revista tash e tutje do të botohej nga Instituti Albanologjik, dy herë në vit. Në periudhën 1971-1996 kjo revistë u botua

në tri seri, një herë në vit. Seria filologjike trajton probleme nga fusha e gjuhësisë, e letërsisë dhe e onomastikës. Brenda tematikës së gjerë që trajtohet në këtë seri dominojnë problemet e gjuhësisë, çështje të historisë së gjuhës, të morfologjisë, të sintaksës, të dialektologjisë, të leksikografisë, të kulturës së gjuhës, të gjuhës letrare etj., duke u përqendruar në tri rrafshë: të gjuhës shqipe, të gjuhësisë shqiptare në krahasim me kulturat e tjera gjuhësore dhe në rrafshin teorik-studimi i problemeve të përgjithshme. Ndihmesat e botuara në të tri seritë e "Gjurmime albanologjike" janë sistemuar në: studime dhe artikuj, materiale, kritika dhe recensione, kronikë shkencore dhe bibliografi. Studimet dhe artikujt e kësaj reviste kanë rezyme në një gjuhë botërore. Vazhdon të dalë një herë në vit. Seria e folklorit dhe etnologjisë përfshin studime dhe trajtesa të fushës së letërsisë popullore, të etnomuzikologjisë dhe të etnografisë. Seria e shkencave historike trajton problematikën e historisë së popullit shqiptar, të historisë së popujve me të cilët shqiptarët jetojnë në fqinjësi dhe kanë marrëdhënie, por edhe të historisë së popujve të tjerë të Europës, me të cilët shqiptarët patën marrëdhënie ekonomike, tregtare, politike, kulturore etj. (Abdurrahim Maxhuni)

REVISTA "HORIZONTET E HISTORISË". Organ i Lidhjes së Shoqatave të Historianëve të Kosovës. Revista filloi të botohet në vitin 1977 dhe deri në vitin 1987 u botuan gjithsej 11 numra. Punimet botoheshin në gjuhën shqipe dhe serbokroate. Ishte e regjistruar me numër Yu ISSN 0351- 0131. Revista botonte kontribute dhe studime historike, mësim të historisë, dokumente, kritika, recensione dhe, në disa numra, edhe diskutime. Bashkëpunëtorë të saj ishin profesorët, studiuesit dhe punëtorët shkencorë të afirmuar të Kosovës dhe të Jugosllavisë. Në rubrikën për mësimin e historisë janë botuar punime teorike dhe shkencore për mësimdhënien e historisë, kurse në rubrikën e dokumenteve janë botuar dokumente të buri-

meve të huaja, që ishin me interes për historinë e Kosovës. Kritikant, recensionet, diskutimet dhe polemikat kishin karakter popullarizues dhe ishin në interes të shkencës dhe të historisë së Kosovës dhe të asaj shqiptare. Revista përfshinte edhe materiale nga tryezat që u organizuan nga Lidhja e Shoqatave të Historianëve të Kosovës. Kryeredaktor i revistës ishte Fehmi Pushkolli. (Haki Kasumi)

REVISTA "KËRKIME GJEOGRAFIKE". Revistë shkencore e departamentit të gjeografisë të Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore të Universitetit të Prishtinës dhe e Shoqatës së Gjeografëve të Kosovës. Nga viti 1979 deri në vitin 1991 u botuan 12 numra. Disa vjet botimi i saj u ndërpre për shkak të mungesës së mjeteve financiare, për të vazhduar më vonë me botim vjetor. Deri më tani janë botuar gjithsej 17 numra, përfshirë edhe numrat jubilarë në përvjetorin e 40-të dhe të 50-të të departamentit të gjeografisë. Autorë të artikujve dhe trajtesave janë kryesisht gjeografët nga departamenti dhe nga Shoqata e Gjeografëve të Kosovës. (Hivzi Islami)

REVISTA "KOHA". Revistë kulturore e shqiptarëve në Mal të Zi, e botuar në periudhën 1978-1989. Ishte revista e parë shqipe e botuar në Malin e Zi. Ishte revistë dymujore për art, shkencë, kulturë dhe çështje shoqërore dhe botohej në Podgoricë (Titograd). Kryeredaktor i saj ishte publicisti Gjergj Gjokaj nga Tuzi. Botoi më së shumti letërsi, artikuj shkencorë, letërsi të përkthyer, sidomos nga gjuha serbokroate. Shkrimet e tyre të para në revistën "Koha" i botuan të gjithë poetët e shkrimtarët shqiptarë që lindën në trevat shqiptare në Mal të Zi. Ajo ndikoi në zbulimin e emrave të rinj, sidomos në letërsi. Në këtë revistë botuan edhe shumica e shkrimtarëve nga Kosova dhe Maqedonia. Me fillimin e daljes së kësaj reviste u ringjall letërsia e shkruar në gjuhën shqipe në Mal të Zi, ndonëse e përbërë nga një numër i kufizuar autorësh. Revista "Koha" botoi edhe disa libra letrarë, kryesisht të autorëve shqiptarë në Mal të Zi. Revista u mbyll më 1989, si rrjedhojë e zhvillimeve të atëhershme politike në vend. (Haxhi Shabani)

REVISTA "KOSOVA" (1971). Revistë shkencore, organ i Institutit të Historisë së Kosovës në Prishtinë. Fillimisht (nga viti 1971) botohej

me titullin "Kosova-Kosovo" në gjuhën shqipe dhe serbokroate, me rezyme në gjuhën frënge. Nga viti 1995 vazhdoi të botohej vetëm në gjuhën shqipe me emrin "Kosova", me rezymetë në gjuhën angleze. Janë botuar gjithsej 40 numra. Punimet e botuara në revistë përfshijnë periudha të ndryshme të historisë së Kosovës dhe më gjerë, përfshirë periudhën antike, mesjetare dhe bashkëkohore. Një vend të veçantë në revistë zinin tekstet studimore për Rilindjen Kombëtare Shqiptare, kryengritjet shqiptare të fillimit të shek. XX, luftërat ballkanike, Luftën e Parë dhe të Dytë Botërore, për Luftën Nacionalçlirimtare dhe periudhën pas Luftës së Dytë Botërore, si dhe për ngjarjet dhe personalitetet e njohura historike. Përveç autorëve nga Kosova, në revistë i kanë botuar punimet e tyre edhe studiues nga Shqipëria, nga ish-Jugosllavia dhe më gjerë. Që nga numrat e parë, revista i ka rubrikat standarde: studime e artikuj, materiale dhe dokumente dhe kritika e recensione. Kryeredaktor i parë i revistës, deri më 1981, ishte Ali Hadri, më pas Tahir Abdyl, Fehmi Rexhepi, Jusuf Bajraktari, Frashër Demaj dhe nga viti 2015, Sabit Syla. (Fehmi Rexhepi)

REVISTA "KOSOVA" (Revistë historike-politike). Botim i përbashkët i Institutit të Historisë në Prishtinë dhe i Institutit të Historisë në Tiranë. Që nga vitit 1993 e deri në vitin 1999 dolën gjithsej 8 numra në gjuhën angleze (Tiranë) dhe 8 numra në gjuhën shqipe (Prishtinë). Revista u shpërndahej përfaqësuesve diplomatikë përmes Zyrës së Republikës së Kosovës në Tiranë dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë. Kishte për qëllim sensibilizimin dhe informimin e opinionit politik dhe diplomatik për gjendjen e Kosovës, të kaluarën e saj dhe luftën që bënte për çlirim nga pushteti serb. Nëpërmjet artikujve shkencorë revista u përpoq t'u kundërvijë shtrembërimeve që i bëheshin prej shumë kohësh historisë së Kosovës nga historiografia serbe. Në mbështetje të të dhënave të dokumentuara dhe të arritjeve të shkencave albanologjike në faqet e revistës u prezentua trashëgimia me vlera të veçanta kulturore-historike e shqiptarëve të Kosovës, aspektet etnolinguistike e demografike të Kosovës dhe trevave të tjera shqiptare, vazhdimësia etnokulturore dhe historike, autoktonia e tyre dhe një sërë çështjesh të tjera më pak të njohura

për opinionin e huaj. Me punimet e botuara revista u dallua për objektivitet në trajtimin e problemeve të historisë së Kosovës. (Fehmi Rexhepi)

REVISTA "KOSOVARJA". Revistë për gruan dhe familjen, e cila filloi të botohej nga viti 1971, së pari në kuadër të njësisë së revistave të "Rilindjes", ndërsa nga viti 1999 e



pavarur. Është revista më jetëgjatë në gjuhën shqipe për problemet e gruas dhe familjes. Botimi i saj nuk ka pasur ndërprerje, madje as në kohën e luftës. Ka qenë dhe mbetet revista më e kërkuar dhe më e shitur.

Paralelisht kishte edhe botimin në diasporë. Lexueshmërinë e ka arritur me shkrime dhe tema interesante e aktuale për lexuesin: biseda dhe intervista me persona të ndryshëm, nga qytetari i rëndomtë deri te personalitetet publike të të gjitha fushave, reportazhe nga përditshmëria, si dhe rubrika nga edukimi, shëndetësia, përfshirë edhe tema argëtuese. Në drejtimin e revistës janë shquar shumë emra, por për zhvillimin e saj dhanë kontribut veçmas kryeredaktorja e parë Sanije Gashi dhe kryeredaktori shumëvjeçar Gani Dili. (Artan Krasniqi)

REVISTA "LIBRI SHKOLLOR". Revistë arsimore-pedagogjike dhe shkollore e Entit të Teksteve dhe Mjeteve Mësimore të KSA të Kosovës, e cila filloi të botohet në vitin 1971. Qëllimi i saj ishte "të trajtojë problematikën e ndërlikuar rreth hartimit, përpilimit e vlerësimit të teksteve të ndryshme shkollore". Në revistë u trajtuan çështje të ndryshme të teksteve shkollore të të gjitha niveleve të shkollimit, përfshirë edhe konceptonet për hartimin dhe kriteret për vlerësimin e teksteve shkollore origjinale, për lëndë dhe klasa të ndryshme. Revista hapi edhe rubrika të tjera për çështje pedagogjike, ku u botuan edhe projekt-propozimet e planeve dhe programeve mësimore dhe inkurajoi edhe analizën dhe vlerësimin kritik të tyre. Autorë të punimeve në këtë revistë ishin, në radhë të parë, punonjësit profesionistë të Entit dhe bashkëpunëtorët e tij. Nisi si revistë tremujore, por doli në intervale të ndryshme kohore. Numri i fundit u botua në vitin 2000. (Islam Krasniqi)

REVISTA "LOJA". Revistë profesionale për fushën e teatrit. U themelua më 2006, nga regjisori Bekim Lumi dhe nga disa krijues të tjerë të rinj të teatrit. Nga viti 2006 deri më 2010 u botuan pesë numra të kësaj reviste. Shkrimet e kësaj reviste (origjinale dhe të përkthyer) kanë karakter analitik, studimor, kritik, eseistik, biografik e informativ. Në faqet e saj ka zënë vend një pjesë e konsiderueshme e dijes teorike dhe e përvojës krijuese të mjeshtërve të mëdhenj të teatrit avangardist të shek. XX. Aty janë paraqitur edhe profilet e disa artistëve të shquar të vendit dhe të huaj, si dhe disa drama bashkëkohore. Çdo numër i kësaj reviste, me një pjesë të mirë të shkrimeve të botuara, në përvjetorë të ndryshëm jubilarë, i është kushtuar disa nga figurave më të njohura të teatrit botëror apo vendor. (Besim Rexhaj)

REVISTA "MM". Revistë teorike dhe letrare, që u botua në periudhën 1995-2011. Revista kishte për qëllim kultivimin e mendimit të hapur e kritik, reflektimin mbi proceset e transicionit në shoqërinë shqiptare dhe prezantimin e rrjedhave bashkëkohore në fushën e letërsisë dhe të arteve. Revista kishte dy redaksi, një në Prishtinë dhe një në Tiranë, në përpjekjen për të nxitur integrimin kulturor shqiptar. Me ndërprerje të herëpashershme, revista arriti të botohej në 23 numra. Me tekstet e botuara nga fushat e ndryshme të shkencave dhe të arteve, revista dha kontribut në avancimin e diskursit teorik në kulturën shqiptare. Kryeredaktorë të saj ishin Shkelzen Maliqi dhe Anton Berishaj. (Anton K. Berishaj)

REVISTA "MONUMENTET E KOSOVËS". Është publikim i Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës në Prishtinë. Numri i parë i revistës doli në vitin 1961. Në periudhën 1961-1997 dolën nga shtypi dhjetë numra të revistës "Starine Kosova-Antikitete e Kosovës". Pas luftës 1998/99 revista u emërua "Monumentet e Kosovës." Me këtë emër dolën dy numra të revistës, numri i parë në vitin 2004 dhe i dyti në vitin 2014. Në këto dy botime u publikuan punimet e ekspertëve të institutit, si dhe të bashkëpunëtorëve të jashtëm. Publikimet paraqesin kryesisht rezultatet e hulumtimeve shkencore nga lëmi i ruajtjes, mbrojtjes, konservimit dhe të restaurimit të trashëgimisë kulturore-historike të Kosovës. U botuan studime, artikuj

profesionalë, raporte, informata të ndryshme nga kërkime arkeologjike, arkitektonike, pikturale, epigrafi etj. Disa punime përfshijnë fushën e konservim-restaurimit të objekteve dhe komplekseve arkitektonike, të freskave të stilit bizantin, monumental dhe narrativ, si dhe të dekorimeve, apo arabeskave në monumentet sakrale, në pikturat murale të kishave dhe të xhamive në Kosovë. Revista publikoi studime të trashëgimisë kulturore-materiale të periudhave të ndryshme historike, duke filluar nga parahistoria e deri te artet pamore bashkëkohore. Revista "Monumentet e Kosovës" edhe aktualisht vazhdon të botohet. (Fejz Drançolli)

REVISTA "MORRI". Revistë humoristike-satirike, e cila nisi botimin në maj të vitit 2000 në Prishtinë. Ishte vazhdim i shtojcës humoristike, që dilte në kuadër të revistës "Kosovarja" dhe lexohej në masë, për shkak të temave dhe mënyrës shpotitëse të paraqitjes së dukurive dhe fenomeneve në shoqërinë e Kosovës gjatë viteve '90. Revista ishte e përdyjavshme, së fundi mujore. Pushoi të dalë në fund të vitit 2003. Botues e kryeredaktor ishte Ali Mehmetaj. (Ibrahim Berisha)

REVISTA "ORA". Revistë e përjavshme, botim i Lidhjes Demokratike të Kosovës në Prishtinë. Numri i parë doli në prill të vitit 1991, me kryeredaktor Mehmet Krajën dhe zëvendëskryeredaktor Ibrahim Berishën. Ishte revista e parë në gjuhën shqipe në Kosovë e faqosur dhe e dizajnuar në kompjuter. Në numrat e saj u trajtuan tema politike, ekonomike, kulturore, sportive etj., nga emra të njohur të gazetarisë dhe publicistikës shqiptare. U botuan 20 numra dhe më pas, për shkak të pengesave të ndryshme, u ndërpre botimin i saj. Ndonëse ishte organ i një partie, revista krijoi një rrjet të gjerë bashkëpunëtorësh, pavarësisht nga përkatësia e tyre partiake dhe orientimi politik. Arriti të tubonte rreth vetes penat më të shquara të publicistikës dhe të kulturës në Kosovë. (Ibrahim Berisha)

REVISTA "PËRPARIMI". Revistë shkencore dhe publicistike, e cila filloi të botohej në Prishtinë në maj të vitit 1946. Ishte revista e parë për kulturë dhe krijimtari, e botuar pas Luftës së Dytë Botërore në Kosovë. Me të iu vunë themelet periodikut dhe publicistikës

shkencore në Kosovë. Synimi kryesor i revistës ishte që puna në shkolla dhe kurset kundër analfabetizimit të ndihmoheshin me një veprimtari botuese, në radhë të parë që të ndihmohej arsimimi dhe emancipimit i përgjithshëm i masave të gjera. Për nxjerrjen e revistës u angazhuan të gjithë ata që kishin njohuri elementare të shkrimit. Në këtë mënyrë revista "Përparimi" u bë tribunë e përhapjes së dijes dhe e zgjerimit të njohurive, duke vënë bazat e emancipimit shkencor në disa fusha të caktuara. Revista nuk u shqua për ndonjë arritje të veçantë, për ndikim në formimin e opinionit shkencor dhe kulturor, por më shumë iu përgjigj prioriteteve të kohës në rrethanat e Kosovës dhe të shqiptarëve në ish-Jugosllavi. Në faqet e saj botuan tekstet e tyre shkencëtarë dhe krijues të afirmuar, por edhe ata që bënin hapet e parë në këtë fushë. Në revistë u botuan punime dhe kontribute pothuajse të të gjitha fushave shkencore: shkencat mjekësore, juridike, politike, teknike, pastaj gjeografi, matematikë, fizikë, kimi, biologji, filozofi, sociologji dhe estetikë, histori e arkeologji, letërsi e gjuhësi, folklor, etnografi, etnologji, muzikologji, bujqësi, art, ekonomi etj. Botimi i saj u ndërpre pas dyzet vjet të daljes së rregullt. (Izber Hoti)

REVISTA "PIONIERI". Revistë letrare për fëmijë që del në Prishtinë nga viti 1949. Filloi të botohej pas Luftës së Dytë Botërore me emrin "Gazeta e pionerëve", por shumë shpejt mori emrin "Pioneri", duke marrë karakterin e revistës letrare për fëmijë. Luajti rol të rëndësishëm për zhvillimin e letërsisë për fëmijë në Kosovë dhe në hapësirat shqiptare të ish-Jugosllavisë. Duke




u shpërndarë edhe nëpër shkollat e fshatrave më të largëta dhe më të veçuara, luajti një rol të madh arsimor, edukativ dhe emancipues. Në faqet e saj i botuan punimet e tyre shumë pena të njohura të kësaj letërsie të re, siç u formuan edhe ilustratorët tanë më të shquar. Me rubrikat e saj "Cicërimat e para" dhe "Hyjet" ajo nxiti shumë autorë të rinj si dhe shërbeu si dritare e çmueshme prej nga fëmijët shqiptarë u njohën me vlerat e krijimtarisë letrare për fëmijë të popujve të tjerë. Pati dhe vazhdon të ketë edhe

rubrikat zbavitëse, si dhe hapësirën për nxitjen krijimtarisë së piktorëve të rinj. Kontribut të veçantë në drejtimin e saj dhanë kryeredaktorët Fehmi Sinella, Hasan Vokshi, Tajar Hatipi, Vehbi Kikaj, Qamil Batalli, Zejnullah Halili, Arif Demolli, Hasan Hasani etj. (Xhevat Sylja)

REVISTA "RECHERCHES ALBANOLOGIQUES" (1984-1987). Revistë shkencore, që për herë të parë u botua më 1984 nga Instituti Albanologjik i Prishtinës, me kryeredaktor Idriz Ajetin. Dilte një herë në vit deri më 1987. U botuan punime të zgjedhura që kishin peshë në njohjen sa më të mirë të kulturës shqiptare. U botua në gjuhën frënge, por kishte punime edhe në gjuhët gjermane dhe angleze. Revista ishte e strukturuar në studime, artikuj, recensione, materiale dhe kronika shkencore. (Abdurrahim Maxhuni)

REVISTA "SFINGA". Revistë që i dedikohej gruas, me tema sociale, kulturore dhe letrare. Kishte për qëllim afirmimin e femrave krijuese. Numri i parë doli më 1997 dhe u botua në shtatë numra. Revista solli risi në hapësirën shqiptare, duke i afirmuar dhe duke u dhënë hapësirë shkrimeve për studimet gjinore, sidomos kritikës letrare feministe. Botoi shkrime origjinale nga shkrimtarë të mbarë hapësirës shqiptare dhe përkthime nga studiuese të njohura të çështjeve feministe. Përmes kësaj reviste studimet gjinore shqiptare u avancuan dhe morën trajtim ndërdisiplinor nga fushat e ndryshme të dijeve shoqërore. Kryeredaktore e revistës "Sfinga" ishte Sazana Çapriqi. (Lindita Tahiri)

REVISTA "STUDIME". Revistë shkencore vjetore e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës që del nga viti 1994. Në 19 numrat e parë, deri më 2013, ka qenë revistë e shkencave filologjike dhe shoqërore, por më pas është ndarë në revistën për shkencat filologjike ("Studime") dhe "Studime shoqërore". E boton Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë i ASHAK-ut. Në 19 librat e parë ka trajtuar çështje që lidhen me fushën e historisë së popullit shqiptar, me fushën e gjuhësisë dhe të letërsisë, të demografisë, të gjeografisë, të



arteve, të muzikës etj. Ndhimesat e botuara në këtë revistë grupohen në artikuj, studime, kritika, recensione, kronika dhe mund të jenë në gjuhën shqipe ose në një nga gjuhët me qarkullim ndërkombëtar, kanë rezymetë në gjuhët me qarkullim të gjerë, përkatësisht në gjuhën shqipe. Bordi redaktues i revistës përfshin anëtarë jashtë Akademisë dhe jashtë Kosovës. (Abdurrahim Maxhuni)

REVISTA "SHËNDETI". Revistë e përmuajshme edukative-arsimore për promovimin e shëndetit, e vetmja e këtij lloji në gjuhën shqipe në ish-Jugosllavi (1953-1991). Filloi të botohet në vitin 1953, një herë në muaj, si organ i ish-Entit Higjienik të Kosovës (sot Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës). Numri i parë i kësaj reviste u botua në 5,000 kopje. Qëllimi i kësaj reviste ishte ngritja e nivelit arsimor dhe edukimit shëndetësor të shtresave të gjera të popullsisë, duke përfshirë njohuritë më të domosdoshme shëndetësore. Vend i rëndësishëm u jepej këshillave për mirërritjen e foshnjave dhe të fëmijëve, higjienës së përgjithshme dhe personale, parandalimit dhe ruajtjes nga sëmundjet ngjitëse, vaksinimit masiv të fëmijëve, ruajtjes së ambientit etj. Që nga viti 1956 revista shpërndahej në të gjitha viset e banuara me shqiptarë në Mali i Zi, Maqedoni dhe Luginë të Preshevës, por edhe në institucionet shkollore në gjuhën shqipe. Botohej në 25,000 kopje e në vitet 1989-1990 deri në 50,000 kopje. Revista "Shëndeti" e ndërpreu botimin më 1991, pas ndërhyrjes së organeve të pushtetit serb dhe nuk u riaktivizua më. (Isuf Dedushaj)

REVISTA "SHKËNDIJA". Revistë arsimore, pedagogjike dhe shoqërore. Filloi të botohet në vitin 1971. Që në numrin e parë njoftonte se qëllimi kryesor i saj do të jetë analiza dhe zgjidhja "e çështjeve aktuale shkollore dhe shoqërore-pedagogjike". Kjo revistë, me rubrikat e saj, u shndërrua në një tribunë të mendimit pedagogjik, të analizës dhe vlerësimit të gjendjes së arsimit në Kosovë dhe të shkëmbimit të pikëpamjeve të ndryshme për të gjitha çështjet profesionale dhe problemet e shkollës dhe të arsimit. Në këtë revistë botuan punimet e tyre dhe u afirmuan shumë pedagogë dhe veprimtarë të arsimit. Revista "Shkëndija" u shndërrua në doracak profesional për mësimdhënësit dhe drejtuesit e arsimit në Kosovë, sidomos për ata të arsimit fillor. Nisi

si revistë dyjavore, por doli në intervale të ndryshme kohore. Pushoi së botuari në vitin 2010. (Islam Krasniqi)

REVISTA "SHQYRTIME JURIDIKE TË KOSOVËS" (KOSOVA LAW REVIEW) (1996-2002). Revistë juridike e Kosovës në gjuhën angleze. U themelua në vitin 1996 dhe u adresojë kryesisht qarqeve akademike dhe diplomatike ndërkombëtare, në kohën para luftës dhe në vitet e para pas luftës së vitit 1999. Fillimisht botues i saj ishte Shoqata e Pavarur e Juristëve të Kosovës, (1996-1998), ndërkaq nga 1999-2002 botues ishte Instituti i Kosovës për Integritet Veriatlantike. Në numrat e kësaj reviste u botuan shumë studime juridike, në të cilët argumentohej shkencërisht pavarësia e Kosovës në aspektin politik dhe konstitucional. Kryeredaktor i revistës ishte Blerim Reka. (Qerim Qerimi)


REVISTA "TERXHUMANI SHARK" (Interpreti i Lindjes) (1878). Revistë politike e botuar në Stamboll, kryeredaktor i së cilës ishte Sami Frashëri. Numri i parë i kësaj revistës doli më 22 mars 1878 në Stamboll. Në faqet e saj zinin vend ngjarjet politike që ndodhnin në Perandorinë Osmane, por dhe në vende të tjera të botës. Botuesi i saj ka qenë Mihran Beu. Sami Frashëri u bë kryeredaktor i gazetës që nga 10 prilli i vitit 1878. Me ardhjen e Samiut si kryeredaktor, "Terxhumani Shark" ndryshoi në përmbajtje. Interesat kombëtare të shqiptarëve kishin vendin e tyre në komentet politike të kësaj gazete. Veprimtaria e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe kërkesa e saj për bashkimin e tokave shqiptare në një vilajet të vetëm autonom parashtroheshin në mënyrë të vazhdueshme nga Samiu, si një përpjekje e ngritur nga shqiptarët e besimeve të ndryshme, për të mbrojtur interesat e kombit shqiptar. Gazeta u mbyll në nëntor të vitit 1878. (Teki Kurti)

REVISTA "THEMA". Revistë e Shoqatës së Filozofëve dhe e Sociologëve të Kosovës. Numri i parë doli në vitin 1984. Gjithsej u botuan 15 numra. Numri i fundit doli në vitin 1996. Krahas teksteve të përkthyer nga fushat e sociologjisë, filozofisë dhe politikologjisë, revista publikoi edhe punime autoriale të autorëve vendorë dhe ndërkombëtarë. Botoi shkrime edhe nga fushat e tjera të shkencave sociale,

si: demografi, histori, drejtësi, pedagogji, psikologji, kulturologji, filologji, kritikë letrare etj. Dhjetë numrat e parë të revistës kanë dalë në dy gjuhë (shqip dhe serbokroatisht), varësisht se nga gjuha në të cilën shkruhej teksti. Punimet shoqëroheshin me rezyme në gjuhën angleze ose frënge. Kryeredaktorë kanë qenë Muhamedin Kullashi, Shkëlzen Maliqi dhe Fehmi Agani. Revista kontribuoi në zhvillimin e mendimit kritik filozofik dhe sociologjik në Kosovë. (Shemsi Krasniqi)

REVISTA “VJETARI” E ARKIVIT TË KOSOVËS (1965-). Organ profesional e shkencor i Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës. Filloi të botohet nga viti 1965, ku publikoheshin artikuj dhe studime nga fusha e arkivistikës dhe historiografisë, pasuri arkivore dhe recensione të botimeve të ndryshme nga arkivat dhe për arkivat. Revista “Vjetar” fillimisht botohej si e përvjetshme, në dy gjuhë, shqip dhe serbisht. Numri i parë doli me emrin “Godišnjak/Buletini”(Pokrajinski Državni Arhiv/Arkivi Shtetëror i Krahinës), kurse nga numri II-III (1970) mori emrin “Vjetar/Godišnjak” (Arkivi i Kosovës - Arhiv Kosova), ndërsa nga viti 2001 vetëm “Vjetar”. Midis viteve 1988-2001, për shkak të masave të dhunshme në institucionet e Kosovës, përfshirë edhe Arkivin, revista u ndal së botuari. Me botimin e serishëm u vunë themelet e periodikut dhe publicistikës arkivore në gjuhën shqipe në Kosovë. Viteve të fundit revista ka luajtur rol të rëndësishëm në rrjedhat e arkivistikës në Kosovë, duke u hapur rrugë ideve dhe të arriturave më të reja në këtë fushë. Deri sot janë botuar 50 numra të revistës, të shoqëruar me një bibliografi të pasur të botuar nga Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës në vitin 2015. Kjo bibliografi përfshin përmbajtjen e “Vjetarit” sipas kronologjisë së botimit, regjistrin e autorëve të shkrimeve sipas alfabetit etj. (Alban Dobruna)

REVISTA “ZANI I RINISË”/ “ZËRI I RINISË”. Numri i parë i revistës për të rinj “Zani i rinisë shqiptare”, më pas “Zani i rinisë” u botua më 15 maj 1945 në Prizren. Redaksinë e parë e përbënin Faik Riza, Ali Loshi dhe Murteza Daci. Revista doli në katër faqe dhe në 1,500 kopje. Përveç përmbajtjeve politike-ideologjike, botoheshin reportazhe dhe tema që shprehin specifikat e jetës së të rinjve në Kosovë. Nxiste aksionet masive të të rinjve: “Mësim, mësim




dhe vetëm mësim”, “T’i mbledhim lëndët sekondare”, “Të zgjedhim fshatin më aktiv” etj. Në vitin 1951 përgatitja dhe botimi i “Zanit” bëhet në Beograd, pasi atje shkuan anëtarët e redaksisë për të studiuar (Masar Murtezai, Ramadan Vraniqi, Rexhai Surroi dhe Murat Morina). Në Prishtinë kthehet në vitin 1956. Mbas vitit 1966 pasurohet me shkrime kritike dhe hulumtuese për shoqërinë dhe të rinjtë, pastaj me përmbajtje për film, kritikë letrare, letërsi botërore, teatër, emancipim gjinor, festivalet, aksione vullnetare në ndërtimin e infrastrukturës, koncerte, bon-ton, kulturë sportive, humor etj. Vëllimi zgjerohet në 24 faqe. Nga kjo revistë u inicua dalja e muajore humoristike “Thumbi”, revistës kulturore “Fjala”, revistës arsimore “Shkëndija” dhe të gazetave për studentë “Bota e re” dhe “Novi svet”. Në “Zërin e rinisë” punuan gazetarë e shkrimtarë të njohur si Ali Sutaj, Gjon Shiroka, Ramiz Kelmendi, Beqir Musliu, Qerim Arifi, Shaip Beqiri, Blerim Shala, Adem Demaçi, Muhamet Mustafa etj. Në revistë u afirmuan shumë autorë, të cilët më pas do të bëhen të njohur në fushën e artit, të shkencës dhe të letërsisë. “Zëri i rinisë” bëri edhe botime nga fusha e publicistikës, të letërsisë dhe të shkencës. Pas vitit 1999 revista u transformua në gazetë ditore “Zëri”. (Ibrahim Berisha)

REVISTA E FOLKLORIT BURIMOR, DRENAS. Është festivali më i madh i folklorit në Kosovë. Krahas festivalit të Gjirokastrës, ka rëndësi të veçantë në aspektin e ruajtjes dhe kultivimit të traditës etnomuzikore shqiptare në përgjithësi. Në skenën e këtij manifestimi shfaqen vlerat e traditës sonë muzikore e etnografike të hapësirës mbarëshqiptare. Si ngjarje kulturore organizohet çdo 4 vjet. Si mbrëmje e folklorit burimor të komunës së Drenasit, me karakter komunal dhe rajonal, mbahej çdo vit që nga viti 1961. Nga viti 1969 në manifestim marrin pjesë grupet nga të gjitha trevat etnografike shqiptare të Kosovës. Në vitin 1974 u bë riorganizimi i manifestimit dhe mori emrin “Revista e folklorit burimor të Kosovës”. Festivali është mbajtur rregullisht deri në vitin 1989, kur e ndërpreu aktivitetin për shkak të rrethanave politike. Në vitin 2002 sërish u bë

riorganizimi dhe manifestimi mori karakter gjithëkombëtar. Në vitet vijuese festivali u mbajt çdo 4 vjet (2006, 2010 dhe 2014). Për prezantim në festival bëhet përzgjedhja e individëve, grupeve, ansambleve dhe trupave përfaqësuese të kulturës popullore shqiptare. Festivali ka karakter garues dhe ndarja e çmimeve, e shpërblimeve për grupe dhe individë bëhet nga juria profesionale. Në këtë festival në të shkuarën janë prezantuar të gjitha llojet e këngëve, duke filluar nga ato të festave pagane, "këngët malsorçe", këndimet e vajzave me gisht në fyt, krijimet e epikës legjendare dhe historike, si edhe lirikat e dasmës, të dashurisë etj. Gjatë viteve janë prezantuar edhe vallëzimet popullore tradicionale, si dhe e tërë etnoorgabologjia tradicionale. Të gjitha grupet pjesëmarrëse pajisen me veshjet tradicionale nga zonat etnografike që i përfaqësojnë. (Visar Munishi)


REVISTA LETRARE "JEHONA", SHKUP.

Revistë për art letërsi dhe kulturë, e cila e nisi botimin nga 1962 dhe doli pandërprerje deri në vitin 2002. Në filltet e saj ishte "revistë për çashtje shkencore, politike, letrare dhe kulture", ndërsa më vonë u profilizua për art, letërsi, shkencë dhe kulturë. Nga fillimi i viteve '70 revista u integrua në Organizatën Botuese "Flaka e vllaznimit". Gjatë vitit të parë (1962) u



botuan vetëm dy numra të revistës, më 1963 katër vëllime me nga dy numra, kurse në vitet vijuese revista botohej e përmuajshme dhe arriti tirazhin prej 1,500 kopjesh. Revista kishte kolegjiunin e redaksisë, i cili udhëhiqej nga kryeredaktori, si dhe këshillin botues. Kryeredaktori i parë i revistës "Jehona" ishte Myrteza Peza, ndërsa më pas revista u udhëhoq nga Xhevat Gega, Sefedin Sulejmani, Rexhep Zllatku dhe në fund nga Kim Mehmeti. Anëtarë të kolegjiunimit të redaksisë ishin emra të njohur të gazetarisë, letërsisë dhe kulturës shqiptare, si: Azem Zylfyiqari, Murat Isaku, Hamit Thaqi, Xhevat Gega, Mateja Matevski, Mahmud Hysa, Qamuran Tahiri, Jakim Sinadinovski, Fehmi Muça dhe Myrteza Peza. "Jehona" ka lënë gjurmë në kulturën dhe letërsinë shqipe që krijohet në Maqedoni. (Fatmir Sulejmani)

REVISTA LETRARE "JETA E RE". Revistë letrare e përdymuajshme. Numri i parë ka dalë në korrik të vitit 1949. Esad Mekuli njihet si kryeredaktori i parë i saj. Në kuadër të redaksisë së revistës një kohë



veproi edhe edicionin i botimeve, i cili u riaktualizua edhe përgjatë viteve '90 të shekullit të kaluar. Përveç punimeve nga gjuhësia (në vitet e para të daljes), "Jeta e re" ka botuar pothuajse kryesisht krijime nga fusha e letërsisë:

letërsi gojore, poezi, tregime, novela dhe fragmente romanesh, drama, por edhe polemika letrare. Krahas letërsisë së traditës e asaj origjinale shqipe, në faqet e kësaj reviste janë botuar edhe krijime nga letërsia e përkthyer, nga letërsitë e popujve të ish-Jugosllavisë dhe nga letërsia botërore. Janë botuar edhe tekste nga muzikologjia, pastaj rubrikat e ndryshme si "Panorama e revistave", "Kronika e ngjarjeve kulturore", "Kopshti letrar" etj. Janë botuar edhe reproduksione të pikturave dhe të grafikave të krijuesve të arteve pamore. Në vitet e para të daljes së saj është konsideruar abetare për krijues dhe lexuesit e saj të shumtë. Për shkaqe financiare, revista ka pasur një ndërprerje prej vitit 2006 deri në vitin 2010. Aktualisht del tri herë në vit. (Ragip Sylaj)

REVISTA LETRARE "SHESHI". Në fillim, nga vitit 1997, ka dalë si nënfiletë mujore për kulturë e revistës së përjavshme politike "Zëri". Pas disa numrave të botimit si nënfiletë, ajo filloi të dalë si revistë e pavarur, në të cilën janë botuar poezi, proza të shkurtra, ese letrare e filozofike, si dhe intervista me krijues letrarë e mendimtarë të njohur. Kryeredaktor i saj ishte Halil Matoshi. Botimi i saj është mbështetur nga donatorë të huaj. Me këtë revistë një kohë ishte identifikuar rrethi i ashtuquajtur "postmodernist" në Prishtinë. Në faqet e saj revista i jepte hapësirë edhe mendimit filozofik e sociologjik, por edhe lëmenjve të tjerë të dijeve humanitare. Në revistë janë organizuar kryesisht debate për postmodernën, pastaj në fushë të filozofisë, pikturës, filmit, poezisë etj. Janë realizuar intervista e bashkëbisedime origjinale me filozofë dhe sociologë të njohur. Në vitin 2004 u ndërpre botimi i saj për shkaqe financiare. (Ragip Sylaj)

REVISTA LETRARE PËR FËMIJË “GËZIMI”.

U botua nga janari 1950 dhe deri në vitin 2005. U dedikohet nxënësve prej klasës së katër deri në klasën e tetë të shkollave fillore. Për herë të parë u botua me emrin “Gazeta e pionierëve”. Nga shtatorit i vitit 1951 dhe deri më 2005 u botua me emrin “Gëzimi”. Revista ishte “organ i pionierëve shqiptarë të Maqedonisë”. Në fillim botohej nga Ndërmarrja botuese “Detska radost” e Shkupit, kurse prej viteve ’70 ishte pjesë e “Flakës së vëllazërimit”. Revista kishte tirazh të madh: në vitet e para 5,000 kopje, në fillim të viteve ’70 rreth 12,000 kopje dhe më 1978 deri në 22,000 kopje. Botohej dy herë në muaj dhe shpërndahej në të gjitha shkollat shqipe të Maqedonisë. Redaktorë shumëvjeçarë të revistës kanë qenë shkrimtarët Mehmedali Hoxha dhe Fejzi Bojku. Revista “Gëzimi” pushoi së botuari nga viti 2005, që kur u shua “Flaka” e Shkupit. (Salajdin Salihu)

REXHA Abedin (1969-1998). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), dëshmor. Lindi në fshatin Vojnik të komunës së Skënderaj.



ABEDIN REXHA

Kreu shkollën e mesme në Skënderaj dhe vijoi studimet në Fakultetin Xehetar-Metallurgjik në Mitrovicë. Ishte ndër pjesëtarët e grupeve të para të luftës çlirimtare në Kosovë, i njohur me nofkën “Sandokani”. Që në rini të hershme filloi veprimtarinë ilegale. Në vitet 1993-1996 emigroi në Gjermani. Më 1996 u kthye në Kosovë dhe më pas, gjatë vitit 1997 ndërmoi një sërë aksionesh ndaj forcave policore serbe. Disa herë kaloi kufirin ilegalisht, për të sjellë armatim nga Shqipëria. Më 6 maj të vitit 1997, duke hyrë nga territori i Shqipërisë për në Kosovë, grupi i tij ra në pritë të forcave serbe, afër Kushninit të Hasit, ku vritet Luan Haradinaj. Në vazhdimësi zhvilloi aktivitetet të dendur për konsolidimin e radhëve të UÇK-së. Më 25 nëntor 1997 forca të policisë serbe me dy autoblanda hyjnë në fshatin Vojnik, në përpjekje për të depërtuar në Lagjen Binaku, por u tërhoqën për shkak të rezistencës së fortë, të cilën e organizoi A. Rexha. Në gusht të vitit 1998 nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së u emërua komandant i Brigadës 112 “Arben Haliti” në Zonën Operative të Drenicës. Në

këtë zonë ishte koordinator dhe pjesëmarrës në një sërë betejash. U vra më 8 tetor 1998 në një pritë ndërmjet fshatrave Kllodërnice e Kastriot të komunës së Skënderajt. (Sabit Sylja)

REXHA Bahri (1987-). Gazetar i sportit. Lindi në Prishtinë. Kreu studimet për gazetari në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës. Filloi të merret me gazetari sportive nga viti 2009 në gazetën “Sport”, në fillim si gazetar dhe më pas redaktor dhe redaktor përgjegjës. Në këtë të përditshme ishte deri në shkurt të vitit 2013, e cila pastaj u mbyll. Pas një kohe të shkurtër filloi punën në gazetën e re sportive “Sport plus”, përsëri si redaktor përgjegjës, kurse në shtator të vitit 2013 u emërua kryeredaktor, ku punoi deri në nëntor 2014, e më pas kaloi në gazetën ditore “Kosova sot”. (Florim Maliqaj)

REXHA Bajram (1933-2000). Mësimdhënës, veprimtar politik. Lindi në Kllazë të Sipërme të Anës së Malit, komuna e Ulqinit. Pas arsimit fillor në Krythë, përkatësisht në Katërkollë, vijoi mësimet në Normalen e Gjakovës dhe të Prishtinës (1955). Studioi gjuhën dhe letërsinë shqipe në Shkollën e Lartë Pedagogjike dhe në Fakultetin Filozofik të Prishtinës (1968). Fillimisht ishte mësimdhënës i gjuhës dhe i letërsisë shqipe në shkollën fillore të Katërkollës (Vlladimirit), por u shqua për punën e tij si profesor i gjuhës dhe i letërsisë shqipe në gjimnazin e Ulqinit (1970-1981). Përveç punës mësimore, B. Rexha organizoi dhe drejtoi jetën kulturore dhe artistike të gjimnazit, nëpërmjet grupeve të nxënësve. Për arsye politike u burgos (1985), mbeti pa punë dhe jetoi në kushte të vështira. Më 1991 themeloi dhe drejtoi Shoqatën humanitare “Nënë Tereza”, dega në Ulqin. Ishte pjesëmarrës aktiv në jetën kulturore të qytetit të Ulqinit. Në vitet ’90 kontribuoi në themelimin e Lidhjes Demokratike në Mal të Zi (1990), si dhe të Unionit Demokratik të Shqiptarëve në Mal të Zi (1993), duke u zgjedhur kryetar dhe kryetar nderi i kësaj partie politike. (Hajrullah Koliqi)

REXHA Ekrem (1961-2000). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) i njohur me emrin e luftës “Komandant Drini”. Lindi në fshatin Lubizhdë të komunës së Prizrenit. Pas gjimnazit ushtarak në Beograd, kreu Akademinë Ushtarake në Sarajevë (1984), ku



EKREM REXHA

më pas u zgjodh ligjërues në këtë akademi. Në mars të vitit 1993 u çmobilizua nga radhët e ushtrisë jugosllave dhe u kthye në Prizren. Në maj të vitit 1998 iu bashkua UÇK-së në Kabash të Prizrenit. Në korrik u emërua shef

i Shtabit të UÇK-së për Prizren në Vërrin. Më vonë u emërua komandant i Brigadës 125. Në shtator të vitit 1998 shkoi në Shqipëri, me detyra profesionale në ushtrimin dhe stërvitjen e ushtarëve të UÇK-së, ndërsa më 14 dhjetor, së bashku me shumë pjesëtarë elitë të UÇK-së, u kthye në Kosovë. Po atë ditë në bjeshkët e Pashtrikut ky formacion ushtarak u ndesh me forca të mëdha armike. Në këtë betejë nga radhët e UÇK-së ranë disa pjesëtarë të UÇK-së, kurse E. Rexha me shumë ushtarë çau rrethimin e forcave serbe. Më pas riorganizoi forcat e UÇK-së në fshatrat e Suharekës. Me vendim të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së u emërua komandant i Zonës Operative të Pashtrikut. Mori pjesë në shumë beteja, si në bjeshkën e Kabashit, Malësi të Vërrinit, në Drenicë, Berishë, Jezerc e gjetiu, ku u plagos dy herë. Në maj të viti 1999, me vendim të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, u emërua drejtor i Shkollës Ushtarake dhe i Doktrinës së UÇK-së. Në qershor të vitit 1999 hartoi planin operativ për operacionin e çlirimit të Prizrenit. Më 11 qershor 1999 filluan edhe aksionet luftarake për çlirimin e Prizrenit, duke pamundësuar kështu që të digjet qyteti dhe të masakrohet popullata e pambrojtur. Më 14 qershor 1999 ushtarët e UÇK-së, të prirë nga E. Rexha hynë në Prizrenin e çliruar. U vra më 8 maj të vitit 2000. (Bedri Muhadri)

REXHA Iljaz (1940-). Orientalist, profesor universiteti. Lindi në Barilevë të Prishtinës, ku e kreu shkollën fillore, ndërkaq të mesmen e kreu në Sarajevë. Kreu studimet në degën e orientalistikës të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Sarajevës. Studimet pasuniversitare, magjistraturën dhe më pas doktoraturën (2003) i kreu në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës (UP). Në periudhën 1969-1983 punoi në Arkivin e Kosovës, ndërkohë ishte i angazhuar si mësimdhënës në degën e historisë dhe të orientalistikës në Universitetin e Prishti-



ILJAZ REXHA

nës. Në vitet 1983-2007 punoi si mësimdhënës i rregullt po në këto dy degë. U mor me hulumtimin e dokumentacionit historik në arkivat e vendeve ballkanike (Stamboll, Ankara etj.) dhe në arkiva perëndimore. Bëri studime në

fushën e historiografisë, toponomastikës historike mesjetare dhe osmanistikës së periudhës së hershme. Mori pjesë në konferenca shkencore brenda dhe jashtë vendit dhe është autor i shumë artikujve shkencorë dhe profesionalë. Është autor i monografive, “Lidhja Shqiptare e Prizrenit në dokumentet osmane” (1978), “Onomastika mesjetare arbane në arealin e Dardanisë” (2005), “Lidhja Shqiptare dhe Porta e Lartë” (2014) etj. (Hatixhe Ahmedi)

REXHA Kadri (1949-). Veprimtar i lëvizjes atdhetare, ish-i burgosur politik, publicist. Lindi në fshatin Cerrcë të komunës së Istogut. Shkollën fillore dhe gjimnazin i mbaroi në Istog, ndërsa studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe i kreu në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës, ku më pas kreu edhe studimet pasuniversitare. Gjatë vitit shkollor 1972/73 punoi mësimdhënës në gjimnazin e Istogut, ndërsa më vonë, deri në vitin 1978, punoi në një shkollë fillore të Prishtinës. Nga viti 1978 e deri në shkurt të vitit 1982, kur burgoset për veprimtari politike, punoi në Bibliotekën Krahinore dhe Universitare të Kosovës në Prishtinë. Pas vuajtjes së dënimit dhe daljes nga burgu, në vitin 1986 arratiset në Zvicër, ku vazhdoi të jetë aktiv në fushën e politikës dhe të kulturës në radhët e mërgimtarëve. Që herët shkroi poezi dhe më pas, në kohën e studimeve, filloi të merrej me ese dhe publicistikë. Ka botuar një sërë veprash: “Kosovë, gurrë e bardhë” (1989), monografinë për Jusuf Gërvallën “Fati i luleve” (1993), monografinë për Edmond Hoxhën, “Pushkë lajmëtare” (2002), studimin-monografi për Dervish Shaqën (2012), pastaj përmbledhjet me ese e shkrime publicistike “Pikëta-kime letrare” (2013), “Thirrjet e kohës” (2014) etj. Jeton dhe vepron në Zvicër. (Fitim Rifati)

REXHA Nexhmi (1947-). Ekonomist, profesor universitar. Lindi në vitin 1947 në Barilevë të Prishtinës. Pas diplomimit në Fakultetin

Ekonomik të Universitetit të Prishtinës, magjistroi dhe doktoroi në Universitetin e Zagrebit në fushën e marketingut. Në vitin 1973 zgjidhet asistent në Fakultetin Ekonomik e më vonë edhe ligjërues, docent dhe profesor i rregullt për lëndën e marketingut në këtë fakultet. Në vitin 1981 botoi tekstin e parë në gjuhën shqipe për këtë lëndë (“Marketingu”). Qëndroi për studime pasdoktorale në SHBA dhe gjatë periudhës 1990-2007 punoi në Universitetin “Curtin”, në Australi, ku ligjëroi në fushën e marketingut. Nga viti 2004 ligjëroi metodologjinë e kërkimit shkencor në studimet master në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës, kurse në vitin akademik 2007-08 udhëhoqi dhe ligjëroi tri lëndë në studimet e doktoratës në këtë fakultet. Mori pjesë në shumë projekte kërkimore në kuadër të Institutit Ekonomik të Prishtinës. Rezultatet e kërkimeve të tij janë botuar në revistat shkencore të asaj kohe dhe gjithashtu edhe në revistat prestigjioze në SHBA. Ka botuar disa monografi shkencore, si “Dizajni industrial në shoqërinë vetëqeverisëse” (1982), tekste universitare dhe dy fjalorë të terminologjisë ekonomike anglisht-shqip dhe shqip-anglisht. (Besnik Krasniqi)

REXHA Riza (1935-). Historian. Lindi në Kllëzën të komunës së Ulqinit. Shkollën fillore e kreu në Katërkollë, ndërsa Shkollën Normale e kreu në Gjakovë dhe në Prishtinë më 1955. Po atë vit filloi punën e mësuesit në shkollën fillore në Ostros, komuna e Tivarit, ku punoi deri në vitin 1957, ndërsa më pas ishte mësues në shkollën fillore “Bedri Elezaga” në Katërkollë. Në vitin 1964 nis studimet për histori në Fakultetin Filozofik në Prishtinë. Në periudhën 1968-1980 punoi si mësimdhënës i historisë në gjimnazin e Ulqinit, kurse në vitet vijuese, deri në pensionim (1990), punoi në Bashkësinë e Kulturës të komunës së Ulqinit. Mori pjesë në simpoziume dhe konferenca shkencore të historianëve në Mal të Zi, në Kosovë dhe në Shqipëri. Ka botuar librat: “Ulqini në vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit 1878-1881” (1988), dhe “Ulqini dhe politika e Malit të Zi 1881-1912” (2005). Ka botuar edhe një sërë tekstesh nga fusha e historisë në revista dhe gazeta të ndryshme. (Isa Bicaj)

REXHA Xhemajl (1961-1999) Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), dëshmor.

Lindi në fshatin Papaz të Suharekës. Në fillim të viteve '80 u dënua me dy vjet e gjysmë burg për veprimtari politike. Pasi e mbaroi dënimin në vitin 1985 u inkuadrua në radhët e Lëvizjes Popullore të Kosovës. Në qershor të vitit 1998 iu bashkua radhëve të UÇK-së në rajonin e Suharekës. U caktua në batalionin II të Brigadës 123 të Zonës Operative të Pashtrikut në Budakovë, ku kishte edhe pozita komanduese. Ishte komandant i togut, i cili ishte vendosur në fshatin Llanisht, pikë kjo që ishte urë lidhëse mes njësiteve që vepronin në Budakovë, Greiqevc dhe Racë. Mori pjesë në luftimet e 23 gushtit 1998 në Greiqevc. Në afërsi të fshatit Llanisht u plagos rëndë nga predhat e minahedhësit të ushtrisë serbe. U shtrua në spitalin ushtarak në fshatin Breshac, por nuk arriti t'u përballojë plagëve dhe vdiq më 26 gusht 1999. (Ali Uka, Mustafë Haziri)

REXHA Xhemajl (1985-). Gazetar. Lindi në Prishtinë. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu gjithashtu në Prishtinë, përfshirë edhe studimet për shkenca politike në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Nga viti 2005 punon në Televizionin “Kohavision” (KTV), fillimisht si gazetar i politikës dhe i temave sociale. Raportoi nga bisedimet për statusin e Kosovës në Vjenë në vitet 2006-2007, ndërsa në vitin 2008 raportoi gjerësisht për procesin e shpalljes së Pavarësisë së Kosovës dhe ngjarjet pas saj. Në vitin 2009 ideoi dhe është bërë autor dhe producent i emisionit “Interaktiv” në KTV. Gjatë kësaj periudhe realizoi intervista të drejtpërdrejta me shumë pjesëmarrës në zhvillimet politike, shoqërore, kulturore dhe sportive në vend. Gjithashtu realizoi një sërë transmetimesh të drejtpërdrejta për ngjarje të ndryshme, kryesisht politike. Nga viti 2012 është zëvendësues i diskut informativ në KTV. Mori çmime dhe mirënjohje për punën profesionale. (Artan Krasniqi)

REXHA Zekeria (1910-1972). Shkrimtar. Lindi në Gjakovë. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, kurse atë plotore në Tiranë. Mbaroi shkollën e mesme në Liceun Francez të Korçës. Studimet e larta për filozofi i vazhdoi në Francë dhe i mbaroi më vonë në Beograd. Në kohën midis dy luftërave botërore shërbeu në Ministrinë e Arsimit në Tiranë, kurse më 1942 themeloi në Gjakovë dhe për një kohë e drejtoi Shkollën e parë Normale të Kosovës.



ZEKERIA REXHA

Ka qenë pjesëmarrës i Konferencës së Bujanit (1943-1944) si dhe njëri ndër hartuesit dhe nënshkruesit e Rezolutës së saj. Pas luftës punoi si mësimdhënës i filozofisë në gjimnazin e Prishtinës, redaktor i revistës letrare “Jeta e re”

dhe punonjës shkencor i Institutit Albanologjik të Prishtinës. Përveç veprimtarisë arsimore, kulturore e shkencore, bëri përkthimet e para në Kosovë, sidomos të autorëve klasikë francezë dhe të tjerë. Ishte i njohur me pseudonimet e tij: Ramë Zuka, Azi e Shpend Dukagjini. Me pseudonimin e parë botoi ciklin e tregimeve humoristike-satirike me personazhin e Talush Efendisë, i cili u paraqit në vjetët 1951-1956 në faqet e “Jetës së re”. Pas vdekjes së autorit tregimet u botuan nga “Rilindja” në Prishtinë në një libër të veçantë me titullin “Talush Efendija” (1973). Vdiq në Tiranë. (Shaip Beqiri)

REXHA-BALA Kosovë (1929-2004). Shkrimtar. Lindi në Gjirokastër, në një familje me prejardhje nga fshati Kërninë i Istogut. Pasi kreu shkollën pesëvjeçare në vendlindje, vazhdoi shkollimin e mëtejshëm në Kosovë, ku ishte pjesëtar i brezit të parë të Normales së Gjakovës (1947). Një kohë që mësuës në Istog, pastaj gazetar në të përditshmen “Rilindja” të Prishtinës. U burgos nga regjimi jugosllav më 1952 për bindjet e tij politike. Studimet i bëri në Beograd dhe në Göteborg e Malmö të Suedisë, ku pati emigruar pas dëbimit nga vendi si i padëshirueshëm në vitin 1963. Në Suedi punoi në fillim punëtor në një fabrikë, pastaj vazhdoi profesionin e mësuesisë. Pas sprovave të para letrare që kishte bërë në faqet e “Zërit të rinisë”, të “Rilindjes” e të “Jetës së re” në atdhe, vazhdoi më vonë bashkëpunimin me të përkohshmet shqiptare të mërgimit, si “Shëjzat” e Koliqit, “Stinët e jetës” që e udhëhoqi vetë, me “Qëndresën” e R. Rexhepit etj. Bala e vazhdoi veprimtarinë arsimore, publicistike, letrare e atdhetare, duke u angazhuar për afirmimin e çështjes kombëtare gjatë gjithë jetës së tij. Botoi librat me vjersha shqip-suedisht: “Belbëzime poetike” (1972), “Kronika poetike e një shpirti të ndezun” (1974). Më vonë botoi librat poetikë: “Përpykje poetike” (1999), “Thërrime poetike” (2001) dhe një antologji të poezisë suedeze. Vdiq në Göteborg, Suedi. (Shaip Beqiri)

REXHAJ Albatros (1979-). Shkrimtar. Lindi në Prizren. Mbaroi shkollimin fillor dhe të mesëm në qytetin e lindjes, ndërsa studimet në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës, drejtimi i dramaturgjisë. Është autor i një sërë veprash në fushën e prozës dhe të dramaturgjisë. Ka botuar romanet: “Bombë në Beograd” (2012), “Edith” (2013), “Zonja Z” (2014). Është autor i dramave: “Në kërkim të daljes”, “Engjëlli i vdekjes (dramë)”, të cilat janë inskenuar në Teatrin Kombëtar të Kosovës dhe në teatro të ndryshme shqiptare. Librat e tij janë botuar e ribotuar nga disa herë nga shtëpitë botuese të Tiranës. Në Panairin e Librit 2013 në Prishtinë është vlerësuar me çmimin “Autori i vitit 2013”. Është themelues dhe editor i platformës së botimeve elektronike “Filozofia urbane”. Gjithashtu merret me shkrime publicistike, duke qenë kolumnist i rregullt në disa gazeta dhe portale shqiptare. (Adil Olluri)

REXHAJ Besim (1960-) Studiues i dramës, dramaturg, profesor universiteti. Lindi në Pejë, ku kreu arsimin fillor dhe të mesëm. Mbaroi studimet për letërsi dhe gjuhë shqipe në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës (1987). Po në këtë fakultet kreu studimet pasuniversitare dhe mbrojti disertacionin e doktoratës (2006). Në vitet 1990-2005 punoi si redaktor në revistën “Fjala” dhe shkroi një



BESIM REXHAJ

sërë tekstesh diskursive për fenomenet e ndryshme të kulturës. Nga viti 1996, në fillim si bashkëpunëtor i jashtëm, punon në Fakultetin e Arteve (dega e artit dramatik), ndërsa nga viti 1999 ligjëron për historinë e dramës dhe të teatrit botëror dhe për historinë e dramës dhe të teatrit kombëtar. Në vitin 1994 botoi studimin monografik “Tipat e dramës së sotme shqiptare në Kosovë 1950-1990”, në të cilin trajtohen drama dhe teatri në Kosovë nga aspekti i tipologjisë së dramës. Më pas botoi librin studimor në dy vëllime “Drama shqiptare pas Luftës së Dytë Botërore, 1948-2008, poetika, tipologjia, periodizimi” (2009). Në vitin 2010 ky libër mori çmimin “Pjetër Bogdani” të Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës si libri më i mirë i vitit. Më 2011 botoi dramën

trilogji “Vorbulla”, e cila në vitin 2014 u realizua si shfaqje në Teatrin Kombëtar të Kosovës, ndërsa në vitin 2016 botoi librin “Në shenjë të teatrit”. (Bekim Lumi)

REXHEPAGIQ Ahmet (1919-). Veprimtar i arsimit. Lindi në Plavë. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa në Shkup vazhdoi Medresenë e Madhe të Shkupit (1940). U regjistrua në Fakultetin Juridik të Beogradit. Punën mësimore e filloi në shkollën fillore të Vuthajve (1945), pastaj në Guci, ku u shqua edhe si organizator i fushatës kundër analfabetizmit. Ishte edhe gazetar për emisionin në gjuhën shqipe në Titograd. Më pas vazhdoi si mësues në Radushë të Shkupit, ndërsa në vitin 1954 emërohet drejtor i konviktit të Shkollës normale “Zef Lush Marku” po në këtë qytet. Një kohë punoi si gazetar i gazetës “Nova Makedonija”, pastaj sekretar i redaksisë së gazetës “Flaka e vëllazërimit”, përkatësisht edukator në konviktin e shkollave teknike në Shkup. Për angazhim në veprimtarinë arsimore mori çmime dhe dekorata. (Palokë Berisha)

REXHEPAGIQ Jashar (1929-2010). Pedagog, profesor universiteti, akademik. Lindi në Plavë, ku kreu edhe shkollën fillore. Gjimnazin e filloi në Beranë dhe e përfundoi në Pejë. Studioi



JASHAR
REXHEPAGIQ

shkencat pedagogjike në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Zagrebit, ku edhe doktoroi më 1965 për arsimin dhe sistemin shkollor të shqiptarëve në territorin e Jugosllavisë së sotme deri në vitin 1918. Qëndroi në Moskë për një specializim gjashtëmujor. Rreth pesë dekada u mor me veprimtari arsimore-pedagogjike në Kosovë. Punoi në Normalen dhe në Gjimnazin e Prizrenit, në Normalen e Prishtinës, ku ishte edhe drejtor i saj. Ishte mësimdhënës në Shkollën e Lartë Pedagogjike të Prishtinës, këshilltar pedagogjik për shkollat e mesme në Kosovë, si dhe njëri nga themeluesit, mësimdhënës dhe drejtues shumëvjeçar i degës së pedagogjisë të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës, ku punoi nga vitit 1962 deri më 1990. Ishte mësimdhënës i historisë së pedagogjisë dhe i disa lëndëve të tjera pedagogjike në këtë degë dhe në degë të tjera të fakulteteve të Univer-

sitetit të Prishtinës. Kontribuoi edhe në Universitetin e Novi Pazarit, si përgjegjës i studimeve pasuniversitare. Ishte anëtar i rregullt i ASHAK-ut dhe sekretar i përgjithshëm i saj. U shqua edhe në fushën kërkimore-shkencore.

J. Rexhepagiqi u mor me çështje të ndryshme pedagogjike, në radhë të parë me historinë e pedagogjisë botërore, me historinë e arsimit dhe të mendimit pedagogjik shqiptar dhe të popujve të tjerë, me çështje të pedagogjisë aktuale ndërkombëtare, por edhe me çështje socio-pedagogjike, psiko-pedagogjike, didaktike, kulturologjike, metodologjike etj. Botoi një sërë veprash monografike (në gjuhën shqipe, serbokroate, turke, perse), tekste shkollore dhe universitare, si dhe shumë artikuj, vështrime kritike etj. Ndër veprat e tij më të rëndësishme janë: “Tema pedagogjike bashkëkohore” (1966), “Zhvillimi i arsimit dhe i sistemit shkollor të kombësisë shqiptare në territorin e Jugosllavisë deri në vitin 1918” (1970), “Shkollat dhe arsimit në Kosovë nga fundi i shekullit XVIII e deri në vitin 1918” (1974), “Hyrje në metodologjinë e punës kërkimore shkencore” (1975), “Sami Frashëri dhe pedagogjia e Rilindjes Kombëtare” (1995), “Shkolla normale ‘Sami Frashëri’ në Prishtinë 1941-1944” (1997, bashkautor), “Dervishët, rendet dhe teqetë në Kosovë, në Sanxhak e në rajonet e tjera përreth, në të kaluarën dhe sot” (1999), “Tema të zgjedhura dhe bashkëkohore pedagogjike” (2002) etj. Botoi edhe disa përmbledhje poezish. Mori pjesë në shumë takime, konferenca e simpoziume shkencore në Kosovë dhe jashtë saj. Ishte bartës i shumë mirënjohjeve dhe dekoratave. (Hajrullah Koliqi)

REXHEPAJ Daut (1956-). Biolog, profesor universiteti. Lindi në Zabërgjë të Klinës. Shkollimin bazë e mori në Ujmir dhe Kijevë. Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore (FSHMN) e kreu në Universitetin e Prishtinës (UP) në vitin 1980, studimet pasuniversitare i përfundoi në Universitetin e Zagrebit (1988), tezën e disertacionit të doktoratës e mbrojti në FSHMN të UP-së (1991). Një kohë punoi mësimdhënës i biologjisë në shkollën e mesme “Luigj Gurakuqi” në Klinë, pastaj zgjidhet asistent në departamentin e biologjisë në FSHMN të Universitetit të Prishtinës (1981), më vonë merr titullin e profesorit ordinar (2005) për lëndët anatomi krahasuese dhe sistematike e kordateve dhe zoologji e kurrizorëve. Ka

publikuar punime shkencore në revista brenda dhe jashtë vendit. Është bashkautor i disa teksteve shkollore dhe i një praktikumi për lëndën e anatomisë. Specializoi në Universitetin e Miamit në Florida, ku hulumtoi aktivitetin e HSD-së në indet steroidogjenike. (Fetah Halili)

REXHEPI Arnisa (1982-). Pedagoge e muzikës. Lindi në Gjilan. Kreu Shkollën e Ulët për piano dhe Shkollën e Mesme të Muzikës në Gjilan. Studimet i kreu në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës, në degën e pedagogjisë muzikore (2006), ndërsa studimet master për sonologji i mbaroi në Shkup (2011). Është mësimdhënëse në Shkollën e Mesme të Muzikës në Gjilan dhe ligjëruese e lëndës bazat e arsimit muzikor me metodologji dhe lojërat tradicionale muzikore në Universitetin “Kadri Zeka” në Gjilan. Është e angazhuar nga Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë të Kosovës për hartimin e kurrikulave-bërthamë dhe në trajnimin e mësimdhënësve të muzikës. Merret dhe me shkrime muzikore. Më 2015 ka botuar librin e saj të parë (me bashkautore Trena Jordanoska) me titull: “Lojërat muzikore të fëmijëve në Kosovë”. (Kristina Palokaj-Perkola)

REXHEPI Baki (1970-). Gazetar. Lindi në Depcë të Preshevës. Arsimimin bazë e mori në Preshevë, studimet për fizikë i kreu në Universitetin e Prishtinës, ndërsa studimet pasuniversitare për ekonomi i përfundoi në Beograd. Në fillim punoi gazetar i Radiotelevizionit (RTV) “Zëri i Kumanovës”. Në Radiotelevizionin e Kosovës (RTK) nisi punën që nga themelimi i tij në vitin 2000. Gjatë luftës në Luginën e Preshevës punoi për seksionin shqip të Radios BBC për Agjencinë e Lajmeve “Kosovapress” dhe për programin në gjuhën shqipe të Radiotelevizionit të Maqedonisë (2000-2010). Është themelues i RTV “Spektri” në Bujanoc (2003), medium i parë i pavarur në Serbi, që emeton program në gjuhën shqipe. Ishte edhe ligjërues në shkollën e gazetarisë në Bujanoc (2001-2002) dhe themelues i portalit “Presheva-News” dhe kryeredaktor i revistës “Nacional”. Është korrespondent i RTK-së nga Lugina e Preshevës. (Zija Rexhepi)

REXHEPI Brikenda (1976-). Gazetare. Lindi në Prishtinë. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Prishtinë, po ashtu edhe studimet për gjuhë

dhe letërsia angleze në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës. Nga viti 1998 nis punë në gazetën “Koha ditore”. Para dhe gjatë luftës së vitit 1999 shkroi për zhvillimet aktuale, në veçanti për të zhdukurit dhe për personat e zhvendosur, si dhe për praninë e organizatave ndërkombëtare në Kosovë. Ishte redaktore në gazetën e parë të përditshme në gjuhën angleze “KD Times”, e cila u botua deri në mars të vitit 1999. Pas luftës, për afro dy vjet, punoi në departamentin e medieve të OSBE-së dhe në të njëjtën kohë ishte edhe korrespondente nga Prishtina për emisionin në gjuhën shqipe të “Radio France International” (RFI). Më 2002 u kthye sërish në gazetën “Koha ditore”, ku është redaktore. (Zenun Çelaj)

REXHEPI Fehim (1944-2001). Gazetar. Lindi në Kalishtë të Strugës. Në Strugë mbaroi filloren, kurse shkollën e mesme në Shkup. Kreu studimet për shkenca politike në Universitetin e Beogradit dhe një kohë punoi në Radio-Beograd, programi në gjuhën shqipe, si gazetar, moderator, folës e përkthyes. Nga viti 1973 kaloi me punë në Radio Prishtinë, gazetar dhe më pas redaktor e përgjegjës i programit informativ. Më 1989, për shkak të mënyrës së përfshirjes së grevës së minatorëve të Trepçës dhe ngjarjeve që prodhoi ajo në emisionet qendrore të lajmeve të Radio Prishtinës, u përjashtua nga puna. Si korrespondent nga Prishtina u angazhua në “Radio France Internationale” (RFI) dhe një vit më pas komentator në Radion “Europa e lirë” deri në fund të jetës. Ishte analist nga Kosova për Rrjetin Alternativ Informativ. (Zenun Çelaj)

REXHEPI Fehmi (1945-). Historian, profesor. Lindi në Pogradjë të Gjilanit. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, kurse Normalen në Gjilan (1965). Kreu studimet në degën e



FEHMI REXHEPI

historisë në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës (UP) (1971), ku më pas kreu edhe studimet pasuniversitare dhe mbrojtëti disertacionin e doktoratës (1983). Punoi disa vjet në arsim në Pogradjë, në Prishtinë dhe në Gjilan. Nga viti 1978 ishte punonjës shkencor në Institutin e Historisë në Prishtinë.

Në kohën e diferencimeve ideopolitike u përndoq nga pushteti i atëhershëm dhe iu ndalua botimi (1981-1990). Në periudhën 1995-2000 ishte drejtor i Institutit të Historisë, kryeredaktor i revistës “Kosova”, ndërsa nga viti 2003 zgjidhet mësimdhënës në Fakultetin e Edukimit të UP-së dhe pedagog i jashtëm në Universitetin e Tetovës (2003-2005). Është autor i monografive “Gjilani me rrethinë gjatë Luftës së Dytë Botërore” (1998), “Kronikë e shqiptarëve” (2000, botuar edhe në frëngjisht). Është dhe bashkautor i një sërë tekstesh mësimore të historisë për shkollat fillore dhe të mesme, nga klasa IV deri në klasën XII, të botuara në Tiranë dhe në Prishtinë. Botoi edhe një numër artikujsh dhe kontributesh shkencore në revista brenda dhe jashtë vendit. Është kryetar i Lidhjes së Historianëve të Kosovës “Ali Hadri” nga viti 2006. Ishte deputet i Parlamentit të Republikës së Kosovës në dy legjislatura (1992 dhe 1998). (Fitim Rifati)

REXHEPI Ferat (1942-). Biolog, profesor universitar. Lindi në Prellovë, komuna e Skënderaj. Studimet i përfundoi në katedrën e biologjisë të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës (UP) në vitin 1970. Studimet pasuniversitare i mbaroi në Universitetin e Zagrebit (1976) dhe tezën e disertacionit të doktoratës e mbrojti në Universitetin e Osjekut (1978). Një kohë punoi mësimdhënës i biologjisë në gjimnazin e Gjilanit, ndërsa ligjërues u pranua në UP për lëndën e botanikës në Fakultetin e Bujqësisë. Në vitin 1998 zgjidhet profesor i lëndës së botanikës në departamentin e biologjisë të Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore. Ka publikuar punime shkencore dhe profesionale dhe ka mbajtur kumtesa në konferenca shkencore brenda dhe jashtë vendit. Është autor i botimeve të veçanta “Flora e maleve të larta të Kosovës” dhe “Vegjetacioni i Kosovës”. (Fetah Halili)

REXHEPI Ibrahim (1954). Gazetar. Lindi në Slivovë të Ferizajt. Shkollën e mesme e kreu në Ferizaj, ndërsa studimet në Fakultetin Juridik në Prishtinë. Në vitin 1976 punësohet në gazetën e përditshme “Rilindja”, në fillim gazetar dhe pastaj si komentator për çështje ekonomike. Ishte bashkëpunëtor i rregullt i revistës “Koha javore”, si edhe kryeredaktor i revistës së parë për ekonomi në Kosovë, “Afaristi”, e botuar nga Shoqata e Afaristëve

të Kosovës. Ishte edhe kryeredaktor i gazetës “Kosova sot”, pastaj gazetar dhe redaktor në “Koha ditore” dhe bashkëpunëtor i agjencisë AIM (Paris), i gazetës “Flaka” (Shkup), i Radios “Evropa e Lirë” (Pragë) dhe analist në disa gazeta të përditshme në Kosovë. Po ashtu ka qenë trajnuar i angazhuar nga Instituti i Medies i Kosovës IREX. Së fundi udhëheq organizatën joqeveritare “Stras”, qendër për hulumtime strategjike dhe sociale. (Besim Abazi)

REXHEPI Jusuf (1922-2004). Mjek, internist, kardiolog, profesor universiteti. Lindi në Tetovë, shkollën e mesme e filloi në Shkup dhe e përfundoi në Prishtinë. Studimet i filloi në Bari të Italisë (1942-1943) dhe i vazhdoi në Vjenë (1944). Pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore shkoi në Beograd për t’i vazhduar studimet, por për shkaqe politike ia anulujnë të gjithë semestrat dhe provimet, duke e detyruar t’i



JUSUF REXHEPI

rifillojë studimet nga e para. U diplomua në vitin 1952 dhe nisi punën si mjek i praktikës së përgjithshme në Tetovë (1952-1957). Pas kryerjes së specializimit nga mjekësia interne në Fakultetin e Mjekësisë në Shkup, bëri organizimin e shërbimit internistik në spitalin e Tetovës, duke ushtruar edhe detyrën e drejtorit të spitalit deri në vitin 1972. Ndërkohë, në Fakultetin e Mjekësisë në Beograd mbaroi sub-specializimin nga kardiologjia (1970). U largua nga Tetova dhe u vendos në Prishtinë, ku u punësua në Klinikën Interne të Fakultetit të Mjekësisë dhe u emërua mësimdhënës i lëndës mjekësia interne. Mbrojti tezën e doktoratës më 1978. Ishte shef i repartit të kardiologjisë në periudhën 1976-1981, kur u largua nga puna për shkaqe politike. Është autor i tekstit universitar “Ekzaminimi klinik i sëmundjeve të brendshme” (1980) dhe i një sërë punimesh shkencore dhe profesionale. Pas vitit 1992 jetoi dhe veproi në Tetovë. (Isuf Dedushaj)

REXHEPI Labinot (1986-). Balerin, koreograf. Lindi në Rufe të Vjetër të Lipjanit. Shkollimin fillor, të mesëm dhe studimet për koreografi i kreu në Prishtinë. Në periudhën 2002-2013 ishte anëtar dhe balerin profesionist në Baletin e Kosovës. Mori pjesë në shfaqje

të baletit klasik dhe atij bashkëkohor, operë baleti e të baletit muzikor. Me shfaqje të baletit u prezantua në disa festivale, si në Lajpcig të Gjermanisë, në Itali, në Shqipëri, Maqedoni, Bosnjë etj. Punon si mësimdhënës i baletit në shkollën e mesme të muzikës “Prenk Jakova” në Prishtinë. (Ragip Sylaj)

REXHEPI Leonora (1986-). Balerinë. Lindi në Prishtinë, ku mbaroi shkollimin fillor dhe shkollën e mesme të muzikës “Prenk Jakova”, degën e baletit. Anëtare e trupës së Baletit të Kosovës është nga viti 2005. Me shfaqjet e Baletit të Kosovës mori pjesë në shumë festivale kombëtare dhe ndërkombëtare, si në: Shqipëri, Maqedoni, Turqi, Itali etj. Aktualisht është njëra nga solistet e trupës së Baletit, e cila performon në të gjitha shfaqjet e kësaj trupe. (Ragi Sylaj)

REXHEPI Mirlinda (1977-). Piktore. Lindi në Prishtinë. Kreu arsimin fillor dhe të mesëm në Prishtinë, studimet për pikturë në Fakultetin e Arteve po në Prishtinë (1999). Është pjesëmarrëse në një sërë ekspozitash grupore, kombëtare e ndërkombëtare, siç janë ekspozitat tematike “Golgota kosovare” (1999), “Simboli i paqes” (2000), “Arti kundër dhunës” (2001), “Portreti” (2002), “Muslim Mulliqi” (2006), “Krijuesit e rinj” (2007), që të gjitha të mbajtura në Galerinë e Arteve të Kosovës, pastaj në ekspozitat e përbashkëta “Arti modern i Kosovës” dhe “Ekspoart” në Galerinë Kombëtare të Tiranës (2006), në ekspozitën “Krijuesit e rinj” dhe “Populli im dhe një popull tjetër” në Prishtinë (2007), në Sallonin Pranveror dhe në Bienalen e Vizatimit (2015) etj. Në ekspozita grupore u prezantua edhe në Spanjë dhe Austri, ndërsa hapi ekspozita personale në Galerinë e Ministrisë së Kulturës në Prishtinë (2006) dhe në Galerinë “Jatki” në “Nowy Targ” në Poloni, (2008). Në vitin 2005 në Sallonin e Nëntorit mori çmimin e parë për pikturë. (Rexhep Ferri)

REXHEPI Nuhi (1942-). Studiues i letërsisë, profesor universiteti. Lindi në Pogradec të Gjilanit. Kreu shkollën fillore në vendlindje, Shkollën Normale në Prishtinë, ndërsa studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin Filozofik të Prishtinës (1967). Ndoqi studimet pasuniversitare në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Beogradit, ndërsa u doktorua në Universitetin e Prishtinës (1995).

Punoi fillimisht si mësimdhënës në shkollë të Gjilanit, ndërsa nga viti 1972 ishte asistent e më pastaj ligjërues dhe profesor i historisë së letërsisë, i metodikës së letërsisë në degën e letërsisë shqipe të Fakultetit të Filologjisë të Universitetit të Prishtinës. Kreu edhe detyra drejtuese në Fakultetin e Filologjisë, në Universitet dhe në institucione të tjera. Më 2002 botoi monografinë e “Letërsia shqipe në tekstet shkollore të Kosovës 1945-1990”. (Isak Shema)

REXHEPI Ramadan (1940-). Shkrimtar. Lindi në Preshevë. Kreu shkollën fillore në vendlindje, Normalen në Prishtinë. Punoi si arsimtar në Preshevë e Caravajkë. Në këtë kohë nisi studimet e anglishtes në Fakultetin Filozofik të Prishtinës dhe filloi të merrej me krijimtari letrare në fushën e prozës tregimtare. Në vjeshtë të vitit 1963 u arratis nga vendi. Në vitin 1965 u vendos në Suedi dhe vazhdoi studimet në Universitetin e Stokholmit, më pas në Upsala, ku vazhdoi studimet e letërsisë angleze dhe ruse. Në vjeshtë të vitit 1973 u vendos në Malmo. Aty nisi veprimtarinë për informimin dhe arsimimin e mërgatës shqiptare. Më 1974 nxori revistën “Dija”, kurse më 1981 veprimtarinë në kuadër të shoqatës kulturore “Kosova”, në radion “Zëri i Kosovës” (1985-1990), pastaj mori nismën për bashkimin e shoqatave shqiptare në Suedi dhe nxori revistën “Qëndresa” (1991-1996) dhe udhëhoqi Radio ABC (1995-2001). Ka botuar një sërë artikujsh dhe pjesë nga dorëshkrimet e tij letrare e publicistike, ndër të cilat veçohen: “Qorrsoaku”, “Pulëbardha krahtyer”, “Përralla pa mbret” (tregime), “Arbëreshët e Kranjidhit”, “Epilogje”, “Të regjura në llumin e kafes”, “Shin d’Abad ose Përjetimet e pashmangshme të Shin Darbardit”, “Përsiatje të paardhura” (roman për Zef Seremben) etj. R. Rexhepi ka botuar librat: “Kumbonaret” (1963), “Gjymtyrët e një vetmie” (1972), “Reflektimet e një intelektual kosovar” (1974), “Dilemat e Emrush Dokos” (1992), “Urat tona” (1998), “Gjurmë e gjemba” (2004) dhe “Stina e emrave të bukur” (2010). Përveç librit të parë dhe të fundit që u botuan në Prishtinë, librat e tjerë i botoi në Suedi. Jeton në Malmo, Suedi. (Shaip Beqiri)

REXHEPI Ramadan (1962-1999). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK),

dëshmor. Lindi në Sojevë të Ferizajt. Kreu Fakultetin e Kulturës Fizikë në Universitetin e Prishtinës (1986). Punoi si mësimdhënës në shkollat fillore dhe të mesme të Ferizajt. Si sportist kontribuoi në zhvillimin e sportit në Kosovë. Themeloi ekipin e volejbollit dhe klubin e skijimit “Kastrioti” në Ferizaj. Në dhjetor të vitit 1998 iu bashkua UÇK-së në Jezerc, ku u emërua përgjegjës për përgatitjen fizike të ushtarëve. Në janar të vitit 1999 u dërgua në Akademinë Ushtarake “Hamëz Jashari” të UÇK-së në Nishor të Suharekës për aftësim profesional. Më pas u emërua komandant i batalionit të parë të Brigadës 161 të Zonës Operative të Nerodimes. Ishte pjesëmarrës i drejtpërdrejtë i luftimeve dyzet e pesë ditëshe përgjatë tërë vijës së frontit nga drejtimi i Nerodimes, Shtërpcës dhe Budakovës, në drejtim të fshatit Jezerc. Më 5 maj 1999 ra në luftime të drejtpërdrejta kundër forcave serbe në Lagjen Ukzmajli. (Ruzhdi Jashari)

REXHEPI Resul (1953-). Titullar i fesë islame, mësimdhënës, botues. Lindi në fshatin Kuklibeg të Opojës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, kurse të mesmen, Medresenë “Alaudin”, në Prishtinë. Mbaroi studimet në Universitetin e Bengazit, dega El-Beida, në Fakultetin e Gjuhës Arabe dhe të Shkencave Islame (1977). Më 1978 filloi punën në Medresenë “Alaudin” të Prishtinës. Në periudhën



RESUL REXHEPI

1983-1991 ishte drejtor i Medresesë, ndërsa më pas sekretar i përgjithshëm i kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës. Në Fakultetin e Studimeve Islame në Prishtinë ligjëroi lëndët historia e së drejtës së shariatit dhe historia e kulturës dhe e civilizimit islam. Në vitet 1992-1998 drejtoi revistën “Edukata islame”, ndërsa nga viti 2001 është kryeredaktor i “Takvimit”. Në periodikun e Bashkësisë Islame botoi një sërë studimesh dhe trajtesash nga fusha e jurisprudencës islame, pastaj përkthime, vështrime e kontribute të ndryshme. Është autor i monografisë “E drejta martesore islame” (1996), bashkautor i një monografie për Rrustem ef. Shportën dhe përkthyes i disa librave nga fusha e dijeve islame. (Ramadan Shkodra)

REXHEPI Sejdi (1962-). Ekonomist, profesor universiteti. Lindi në Prishtinë, shkollimin fillor dhe të mesëm, si dhe Fakultetin Ekonomik i mbaroi po në Prishtinë, përfshirë edhe studimet pasuniversitare dhe ato të doktoratës. E filloi punën në Universitetin e Prishtinës me titullin profesor asistent, në departamentin e shkencave politike (2004), ndërsa nga viti 2013 është profesor i rregullt në Fakultetin Filozofik. Kreu detyra më rëndësi në institucionet e arsimit të lartë dhe në institucionet shtetërore të Kosovës. Është autor i disa librave nga fusha e ekonomisë dhe e financave: “Boniteti i ndërmarrjeve në kushtet e ekonomisë inflatore”, “Bazat e kontabilitetit” si dhe “Hyrje në kontabilitetin financiar”. Ka botuar edhe disa punime shkencore në revista të ndryshme brenda dhe jashtë vendit. Është profesor i lëndëve ekonomike në departamentin e shkencave politike të Universitetit të Prishtinës. (Alfred Marleku)

REXHEPI Shefqet (1951-). Gazetar. Lindi në Mogillë të Vitisë. Shkollën fillore dhe të mesmen i kreu në Viti dhe në Ferizaj, ndërsa studioi në degën e dramës të Shkollës së Lartë Pedagogjike në Prishtinë dhe për gjuhë e letërsi shqipe në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Punoi mësimdhënës në gjimnazin e Ferizajt, ndërsa nga viti 1978 gazetar në gazetën e përditshme “Rilindja” në Prishtinë. Kryesisht ndoqi zhvillimet në fushën e arsimit. Nga ky sektor bëri shkrime deri në fillim të viteve ‘90, kur filloi të merret me letërsi dhe teatër. Një kohë punoi dhe në gazetën “Kosova sot”, ndërsa disa vjet ishte edhe bashkëpunëtor i rubrikës “Bisedë gjuhë” në Radio Prishtinë. Më pas punoi në zyrën për media në Kuvendin e Kosovës, ndërsa udhëheq Shtëpinë botuese “Andena”. Ka botuar disa libra për fëmijë: “Si e mëson Luli historinë” (2005), “Trekëndëshi artistik” (2008), “Princesha bëhet flutur” (2010) etj. (Veli Bytyçi)

REXHEPI Valbona (1973-). Piktore. Lindi në Prishtinë. Mbaroi shkollimin e mesëm në Prishtinë, ndërsa më 1998 u diplomua në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës, drejtimi i pikturës. Është mësimdhënëse e pikturës në Fakultetin e Arteve. Hapi disa ekspozita personale, si në galerinë “Cemal Resit Ray” në Stamboll (2001), në Galerinë “Rexhep Mitrovica” në Mitrovicë (2005),

në teatrin “Migjeni” në Shkodër (2006), në Galerinë e Ministrisë së Kulturës në Prishtinë (2010), në ambasadën kanadeze në Ankara (2010), në Galerinë “KIC” në Shkup (2011) etj. Ishte pjesë e disa ekspozitave grupore, si në Grac të Austrisë (1998), në Galerinë “Europa” në Shkup (1999), në ekspozitat e përbashkëta “Golgota kosovare”, “Artistët e rinj”, “Arti kundër dhunës”, “Portreti” të mbajtura në Galerinë e Arteve të Kosovës në Prishtinë, pastaj në Galerinë e Fakultetit të Arteve në Madrid (2007), në Shkodër në ekspozitën e mbajtur me rastin e 100-vjetorit të Pavarësisë, në Fakultetin e Arteve në Prishtinë etj. Ishte pjesëmarrëse edhe në ekspozitat e përbashkëta Salloni i Nëntorit, Salloni Pranveror, Bialja e Vizatimit në Prishtinë dhe “Flaka e Janarit” në Gjilan etj. U nderua me disa çmime dhe mirënjohje. (Rexhep Ferri)

REXHEPI Vehbi (1923-1997). Veprimtar politik. Lindi në Gjilan. Shkollën fillore dhe shkollën qytetare publike i kreu në vendlindje, ndërsa Shkollën e mesme profesionale “Realka” në Shkup dhe Shkollën e Lartë Politike në Beograd. Në maj të vitit 1943 u arrestua në Tiranë dhe u dënua me dy vjet e gjysmë burg, prej nga u lirua vetëm pas kapitullimit të Italisë (10 shtator 1943). Ishte ndër themeluesit e Organizatës së Rinisë Antifashiste të Gjilani. Një pjesë të aktivitetit antifashist e zhvilloi në Sanxhak. Në Prijepole burgoset dy herë nga Gestapoja. Pas çlirimit të Prijepoles iu bashkëngjit njësiteve të Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Jugosllavisë, ku qëndroi deri në mars të vitit 1945. Më pas kthehet në Gjilan, ku kreu detyra të shumta me përgjegjësi, deri në tetor të vitit 1950 kur burgoset dhe dërgohet në burgun e Goli Otokut. Pas kthimit nga Goli Otoku, në vitin 1953 shpërngulet në Shkup, ku punoi si fotograf. Më vonë kthehet në Prishtinë dhe e hap studion private të fotografimit. Vdiq në Prishtinë. (Shefki Ukaj).

REXHEPI Vesel (1916-1988). Aktivist politik. Lindi në Gjilan. Shkollën fillore dhe shkollën qytetare publike i kreu në vendlindje, ndërsa Akademinë Tregtare në Shkup. Në vitin 1941 kreu kursin e gjuhës italiane në Palermo të Italisë. Pas Luftës së Dytë Botërore u emërua drejtor i shtëpisë botuese dhe i shtypshkronjës “Progres” në Prizren. Ai solli shtypshkronjën gjermane nga Novi Sadi në Ndërmarrjen

Botuese e Grafike “Rilindja” dhe ishte anëtar i këshillit redaktues të “Rilindjes”. Në vitin 1945 mori pjesë në delegacionin e Komitetit Nacional të Shqiptarëve, që u prit nga Tito në Beograd. Ai e njoftoi kreun jugosllav për Masakrën e Gjilanit. Në vitet 1945-1950 kreu detyra me përgjegjësi në administratën e Kosovës. Për shkak të mospajtimeve me pozitën e shqiptarëve të Kosovës, ishte në shënjestër të organeve të pushtetit. Në gusht të vitit 1950 u arrestua dhe u mbajt për tri vjet në burgun e Goli Otokut. Pas lirimit nga burgu punoi në administratën e Këshillit Ekzekutiv dhe si mësimsdhënës i lëndës së stenografisë në Shkollën e Mesme Ekonomike në Prishtinë. Vdiq në Prishtinë. (Shefki Ukaj)

REXHEPI Xhemail (1944-). Gazetar. Lindi në Teneshdoll të Prishtinës. Shkollën fillore e kreu në Lupç, ndërsa gjimnazin dhe Fakultetin Juridik në Prishtinë. Në vjeshtën e vitit 1967 u punësua në gazetën “Rilindja”, ku punoi një kohë të gjatë si gazetar i sektorit të ekonomisë dhe i Kuvendit të Kosovës. Shkroi tekste të shumta për zhvillimet aktuale të atyre viteve në Kosovë. Ishte zëvendëskryeredaktor i gazetës “Rilindja” në periudhën 1985-1988, ndërsa kryeredaktor i gazetës “Bujku” nga viti 1990 deri në vitin 1993. Pas vitit 2000, për një kohë ishte kryetar i Bordit të Këshillit të Medieve të Shkruara të Kosovës. (Nehat Islami)

REZOLUTA 1160 (31 mars 1998). Rezolutë e Këshillit të Sigurimit (KS) të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) për Kosovën, e miratuar më 31 mars 1998. Kjo Rezolutë, duke vepruar në përputhje me Kapitullin VII të Kartës së OKB-së, i bënte thirrje Beogradit që urgjentisht të ndërmerre të gjitha masat për të zgjidhur çështjen e Kosovës me mjete politike dhe që të përmbushte kërkesat e parashtruara më 9 dhe 25 mars 1998 nga Grupi i Kontaktit. Rezoluta 1160 dënonte përdorimin e dhunës nga policia serbe kundër civilëve dhe demonstruesve paqësorë shqiptarë, ndërsa nga lidërshipi politik kosovar kërkonte të mbetej i përkushtuar në përdorimin e mjeteve paqësore. Në preambulën e saj, Rezoluta vërtetonte përkushtimin e të gjithë anëtarëve të OKB-së në favor të “sovrانيتit dhe integritetit territorial të Jugosllavisë së mbetur” dhe shprehte përkrahjen për “një status të avancuar për Kosovën, që do të përmbante një shkallë

më të lartë të autonomisë dhe vetadministrimit përmbajtësor”. Rezoluta kërkoi edhe praninë e organizatave ndërkombëtare në Kosovë dhe hapjen e Zyrës së Prokurorit të Tribunalit të Hagës për Krime të Luftës. Po ashtu, Rezoluta theksonte se “në rast se përpjekjet për paqe nuk arrinin një parim konstruktiv, do të merreshin në shqyrtim masa të tjera.” Kjo Rezolutë e OKB-së i jepte çështjes së Kosovës dimensionin e një krize me karakter ndërkombëtar dhe, shikuar nga aspekti juridik ndërkombëtar, ajo kishte domethënien e legjitimitetit për ndërhyrje ushtarake në krizën e Kosovës, pasi mbështetej në kapitullin VII të Kartës së OKB-së. (Sylë Ukshini)

REZOLUTA 1199 (23 shtator 1998). Rezolutë e Këshillit të Sigurimit (KS) të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB), që bënte thirrje për armëpushim të menjëherëshëm në Kosovë. Rezoluta u miratua, kur ministrat e Jashtëm të Francës, të Britanisë së Madhe dhe të SHBA-së u pajtuan me ministrin e Jashtëm i Rusisë, Igor Ivanov, për tekstin e një rezolute të re. Rezoluta 1199, e cila u miratua edhe me votën e Rusisë, i referohej Rezolutës 1160 të Këshillit të Sigurimit (KS) të OKB-së dhe dokumenteve të Grupit të Kontaktit. Kjo Rezolutë bënte thirrje për armëpushim të menjëherëshëm në Kosovë, tërheqjen e forcave ushtarake dhe policore nga zona e luftimeve, hyrjen e lirë të organizatave humanitare dhe bashkëpunimin e plotë të autoriteteve të Beogradit me Tribunalin për Krime të Luftës në Hagë. Duke vepruar në bazë të Kapitullit VII, Rezoluta kërkonte ndërmarrjen e hapave të menjëherëshëm për ta përmirësuar gjendjen humanitare dhe për ta parandaluar “katastrofën humanitare që po kërcënohej”. Këshilli i Sigurimit kërcënohej me sanksione të mëtejme, përfshirë edhe “sanksione dhe masa shtesë për ta ruajtur apo rikthyer paqen dhe stabilitetin në rajon”. Një ditë pas miratimit të Rezolutës 1199 të KS të OKB-së, më 24 shtator 1998, ministrat e mbrojtjes të vendeve anëtare të NATO-s, në takimin e Këshillit në Vilmoura të Portugalisë, miratuan të ashtuquajturin “Activation Warning-ACTWARN” (vërejtje për aktivizim), që ishte hapi i parë i përgatitjes për ndërhyrje të kufizuara ajrore në Kosovë. ACTWARN ishte kërcënimi real, për ta siguruar përmbushjen e kërkesave të Rezolutës 1199 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së. (Sylë Ukshini)

REZOLUTA 1203 (24 tetor 1998). Rezolutë e Këshillit të Sigurimit (KS) të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) për Kosovën, e miratuar më 24 tetor 1998. Në bazë të Kapitullit VII të Kartës së OKB-së, Këshilli i Sigurimit shprehu zyrtarisht përkrahjen për dy marrëveshjet e 15 dhe 16 tetorit lidhur me Misionin Verifikues të OSBE-së në Kosovë dhe me Misionin Verifikues Ajror të NATO-s, si dhe kërkoi zbatimin e plotë dhe të menjëherëshëm të tyre nga ana e Beogradit. Në këtë Rezolutë Këshilli i Sigurimit kërkonte nga Beogradi, përkatësisht nga udhëheqja e shqiptarëve të Kosovës, zbatimin e menjëherëshëm të rezolutave të mëparshme, 1160 dhe 1199. Në pikën 3 kjo rezolutë kërkonte domosdoshmërinë e hapjes së një dialogu të menjëherëshëm dhe pa kushte midis autoriteteve të Beogradit dhe përfaqësuesve të Kosovës me ndërmjetësimin e ndërkombëtarëve. Rezoluta i ngarkonte me përgjegjësi autoritetet jugosllave për sigurinë e anëtarëve të Misionit Verifikues të OSBE-së, si dhe për sigurinë e anëtarëve të të gjitha organizatave ndërkombëtare dhe humanitare në Jugosllavinë e mbetur. Në pikën e fundit të Rezolutës kërkohet që nën mbikëqyrjen ndërkombëtare të bëhet hetimi për të gjitha aktet e mizorive mbi popullsinë civile shqiptare, si dhe bashkëpunimi i plotë me Gjykatën Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë. (Sylë Ukshini)

REZOLUTA E KËSHILLIT TË SIGURIMIT TË OKB-SË 1244. Dokument juridik ndërkombëtar, me të cilin administrohej Kosova nga ana e Misionit të OKB-së (UNMIK) pas



KËSHILLI I SIGURIMIT I OKB-SË

luftës së vitit 1999. Kjo Rezolutë u aprovua në Këshillin e Sigurimit të OKB-së më 10 qershor 1999, bazuar “mbi parimet për gjetjen e

zgjdhjes së krizës së Kosovës” (të përfaqësuesve të G-8, Ahtisari dhe Çernomirdin, të pranuar më 3 qershor 1999 nga presidenti i Jugosllavisë së mbetur, Millosheviqi). Rezoluta bazohej në kapitullin VII të Kartës së OKB-së, që autorizonte Kombet e Bashkuara të ndër marrin të gjitha masat për kthimin e paqes. Qëllimi i kësaj rezolute ishte që në Kosovën e pasluftës të vendosej një mision i përkohshëm i OKB-së, si fazë kalimtare drejt statusit final. Hartuesit e saj, si zgjidhje kompromisi brenda Këshillit të Sigurimit të OKB-së, kishin përafuar dy qëndrimet e kundërta të dy anëtarëve të përhershëm, SHBA-së dhe Ruisisë. Për ta evituar veton e Ruisisë, Kosova në pikën 11 të kësaj Rezolute mbetej “nën sovranitetin e RFJ-së” dhe emërtohej “territori”, kurse populli i saj “banorë”. Nga ana tjetër, për të kënaqur SHBA-në, në Rezolutë ishte përcaktuar dispozita për përgatitjen e territorit nën administrim të përkohshëm për statusin final, që përcaktohej në pikën 10: “UNMIK-u do të mbikëqyrë bartjen e pushtetit nga institucionet e përkohshme vetëqeverisëse të Kosovës tek institucionet e krijuara pas zgjidhjes politike”. Rezoluta përcaktonte pesë faza të administrimit ndërkombëtar në Kosovë: e para, vendosja dhe konsolidimi i UNMIK-ut; e dyta, administrimi i shërbimeve sociale dhe konsolidimi i sundimit të ligjit; e treta, finalizimi i përgatitjeve për zgjedhjet e para në Kosovë; e katërta, mbështetja e krijimit të institucioneve të përkohshme vetëqeverisëse të Kosovës të dala nga zgjedhjet e para dhe, e pesta, bartja e pushtetit tek institucionet legjitime politike të Kosovës. Kjo fazë e fundit përfundoi me shpalljen e pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008 dhe me të ishte plotësuar edhe misioni i kësaj rezolute. Mirëpo, me që aprovimi i çdo rezolute të KS të OKB-së kërkon së paku nëntë nga 15 votat e anëtarëve të saj, përfshirë 5 votat e anëtarëve të përhershëm, as pas 16 vitesh Rezoluta nuk u shfuqizua. Formalisht, ajo është ende në fuqi dhe në çdo mbledhje të Këshillit të Sigurimit, Rusia e trajton atë si një dokument valid juridik. Ndërkaq, faktikisht, kjo Rezolutë është e tejkaluar vetvetiu nga zhvillimet që ndodhën në Kosovë dhe rreth Kosovës: Që nga viti 2002 nuk ekzistonte më Republika Federative e Jugosllavisë (kurse pika 11 e kësaj rezolute pikërisht e mbante Kosovën “nën sovranitetin” e këtij shteti tashmë të paqenë), ndërkaq që

nga viti 2006 nuk ekzistonte as Unioni Serbi-Mali i Zi. Rezoluta 1244 tashmë bie ndesh edhe me mendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, organit kryesor gjyqësor të OKB-së, i cili në korrik të vitit 2011 qartë vlerësoi se “shpallja e pavarësisë së Kosovës nuk shkeli të drejtën ndërkombëtare”. Në vitin 2015 mbetën vetëm edhe dy dokumente që vazhdojnë të injorojnë realitetin e ri politik në Kosovë: Rezoluta e KS 1244/1999 dhe Kushtetuta e Serbisë. Në dhjetor të vitit 2014 është kërkuar nga Bashkimi Europian (BE) që kjo e fundit të ndryshohet, si parakusht që Serbia t’i fillojë negociatat për anëtarësim në BE. (Blerim Reka)

REZOLUTAT E KONGRESIT AMERIKAN PËR KOSOVËN (1986-1999).

Dokumentet zyrtare të Dhomës së Përfaqësuesve dhe të Senatit të SHBA-së që trajtonin problemin e Kosovës deri në shpërthimin e luftës në vitin 1999. Rezoluta e parë për Kosovën në Kongresin e SHBA-së u aprovua më 17 qershor 1986. Pas saj, gjatë periudhës 1986-1999, Kongresi Amerikan aprovoi 16 rezoluta në Dhomën e Përfaqësuesve dhe 6 rezoluta në Senat. Po ashtu, gjatë kësaj periudhe SHBA-ja trajtoi çështjen e Kosovës edhe në 14 akte të saj ligjore, nënligjore dhe të ashtuquajturit “urdhra ekzekutive”. Të gjitha këto dokumente juridike dhe politike të Kongresit Amerikan ishin mbështetja e parë dhe më e fuqishme ndërkombëtare për Kosovën nën pushtimin serb dhe në prag të luftës. Pos qasjes fillestare për “dënimin e shkeljes së të drejtave të njeriut” dhe “gjykimin e dhunës së regjimit serb kundër shqiptarëve në Kosovë”, rezolutat e mëvonshme kishin kërkesa statusore. Fillimisht, ato të viteve 1989-1991 kërkonin rikthimin e autonomisë së rrënuar të Kosovës nga ana e Serbisë, (“autonomi e plotë”; apo “Republikë në RSFJ/RFJ”), ndërkaq rezolutat e mëvonshme, pas vitit 1992, kërkonin që shqiptarëve në Kosovë t’u njihej e drejta për vetëvendosje (“Republikë e pavarur dhe sovranë”). (Blerim Reka.)

REZOLUTAT E KS të OKB-së PËR KOSOVËN (1998-1999).

Dokumentet zyrtare të Këshillit të Sigurimit të OKB-së që trajtonin çështjen e Kosovës para aprovimit të Rezolutës 1244/99. Vetëm pas shpërthimit të luftës në Kosovë, Këshilli i Sigurimit kishte filluar t’i adresojë seriozisht problemin të Kosovës. Gjatë vitit 1998 kishte aprovuar 3 rezoluta: UNSCR

1160/1998, UNSCR 1199/1998 dhe UNSCR 1203/1998. Me Rezolutën e parë, Këshilli i Sigurimit i OKB-së kishte aplikuar embargo të armëve ndaj RFJ-së. Me Rezolutën e dytë, (duke vepruar sipas kapitullit VII të Kartës së OKB-së), KS kërkoi “ndëprerjen e luftimeve, armëpushimin, vendosjen e një misioni monitorues ndërkombëtar, tërheqjen e forcave të armatosura serbe që ushtronin represion ndaj popullsisë civile dhe hapjen e dialogut për të ardhmen e Kosovës”. Bazuar në këtë Rezolutë të KS-së, më 13 tetor 1998 në Beograd ishte arritur Marrëveshja Millosheviq-Holbruk për vendosjen e misionit të parë monitorues verifikues (OSCE-MKV), kurse më 25 tetor të po atij viti Këshilli i Përhershëm i OSBE-së e kishte lejuar vendosjen e këtij misioni në Prishtinë. Me Rezolutën e tretë (1203) KS konstatonte vendosjen e këtij misioni të OSBE-së, por edhe shprehte shqetësimin për mosimplementimin e kërkesave të rezolutës paraprake, sidomos ato për ndaljen e luftimeve dhe fillimin e dialogut për të ardhmen e Kosovës. E përbashkëta e të gjitha këtyre tri rezolutave ishte trajtimi i “Kosovës brenda sovranitetit të RFJ-së”, qasje që u bart edhe në Rezolutën 1244/99. Edhe pse një qasje e tillë ishte e papranueshme për popullin e Kosovës, këto tri rezulota të KS të OKB-së të vitit 1998 për herë të parë e trajtuan zyrtarisht çështjen e Kosovës në Këshillin e Sigurimit të OKB-së. (Blerim Reka)

REZOLUTAT EUROPIANE PËR KOSOVËN. Dokumentet zyrtare të Bashkimit European (BE) për Kosovën, që nga shpërbërja e ish-Jugosllavisë. Fillimisht BE-ja në të gjithë



PARLAMENTI EUROPIAN

dokumentet e trajtonte problemin e Kosovës si problem “minoritar”, si “çështje të shkeljes së të

drejtave të pakicave kombëtare” dhe si “shkelje e të drejtave të njeriut”, por jo edhe si çështje statusore. Kjo thuhej qartë në rezolutat e Parlamentit European (PE) të viteve 1989-1991. Ndërkaq, Rezoluta e PE-së e 15 marsit 1991 për herë të parë i referohet Kosovës si çështje statusore. Aty thuhej se zgjidhja e problemit të Kosovës “nuk mund të arrihet me ndryshimin e kufijve”, duke e trajtuar Kosovën si “pjesë e Republikës Federative të Jugosllavisë” (RFJ). Pas shpërbërjes së ish-Jugosllavisë, Komisioni i Arbitrazhit i BE-së (Komisioni i Badinterit, 1991-1992) e përjashtoi Kosovën nga procesi i njohjeve shtetërore, pas disolucionit shtetëror të ish-Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (RSFJ), duke refuzuar kërkesën e Qeverisë së Përkohshme të Kosovës që, në mbështetje të referendumit të viti 1991, edhe Kosova të ishte subjekt i sovranitetit shtetëror, nga ajo që kishte mbetur pas shpërbërjes së ish-Jugosllavisë. Edhe pse ishte qëndrim i PE-së që t’u njihej e drejta e vetëvendosjes të gjitha njësive konstitutive të ish-Jugosllavisë, kjo e drejtë nuk iu njoh edhe Kosovës. Në anën tjetër, Bashkimi European (BE) në vitin 1996 njohu pa kushte RFJ-në, ndonëse në rezolutat e saj “dënonte shkeljet e të drejtave të shqiptarëve të Kosovës” nga regjimi serb.

Vetëm pas shpërthimit të luftës në Kosovë, sidomos pas masakrës së Prekazit, fillon të ndryshojë qasja zyrtare e BE-së, e cila nga ajo fillestarja e “shkeljes së të drejtave të njeriut”; filloi ta kualifikojë problemin e Kosovës si “kërcënim për stabilitetin rajonal” (Rezoluta e PE-së, 13 mars 1998), kurse në rezolutat vijuese, për të parën herë përmendet statusi i Kosovës, me ç’rast BE-ja kërkonte “përcaktimin e statusit të ardhshëm politik të Kosovës me ndërmjetësim ndërkombëtar”, duke kërkuar “përgjegjësi për krimet e luftës dhe spastrimin etnik në Kosovë” (Rezoluta e PE-së, 14 maj 1998). Përfundimisht, me Deklaratën e Këshillit të Ministrave të BE-së (Luksemburg, 8 qershor 1998) dhe Deklaratën e Këshillit të Europës (Kardif, 18 qershor 1998) për herë të parë BE-ja e adreson qartë përgjegjësinë e Serbisë për masakrat ndaj popullsisë civile, me konstatimin për “agresion të forcave serbe të sigurimit” dhe “domosdonë e tërheqjes së forcave speciale dhe të Armatës Jugosllave nga Kosova”. Pas luftës së Kosovës, deri në vitin 2006, BE-ja vazhdoi të jetë njëra nga 4 shtyllat e UNMIK-ut, duke qenë donatori më

i madh i rindërtimit të Kosovës, por politikisht duke respektuar Rezolutën 1244/99 dhe duke e trajtuar Kosovën “brenda RFJ-së” dhe më vonë “brenda Unionit Serbi-Mali i Zi”. Pas pavarësimit të Kosovës, BE-ja kishte dy qasje të ndryshme për Kosovën brenda institucioneve të saj. Këshilli i Europës vazhdoi të mos e njihje pavarësinë e Kosovës, duke mbajtur qëndrim neutral ndaj statusit të saj, ndërsa Parlamenti European, që nga viti 2008 deri në vitin 2015, në të gjitha rezolutat e tij, kërkonte nga Këshilli European ta njihje Republikën e Kosovës. (Blerim Reka)

RILINDJA KOMBËTARE SHQIPTARE. Lëvizje e gjerë kombëtare shqiptare, me synim çlirim të vendit nga sundimi osman dhe ngritjen e një shteti të pavarur dhe të një kombi të përparuar. Rilindja Kombëtare Shqiptare u ngrit mbi modelin e lëvizjeve politike europiane, të bazuara në ide iluministe për emancipimin e kombeve dhe për krijimin e shteteve kombëtare. Ajo nisi në vitet ‘30-‘40 të shekullit XIX dhe vazhdoi deri në vitin 1912, me shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë. Rilindja shënoi një shkallë më të lartë të zhvillimit të gjithëmbarshtëm të popullit shqiptar, duke filluar nga mirëqenia, të drejtat kombëtare, vetëdija politike, arsimore, kulturore. Rilindja Kombëtare Shqiptare ishte lëvizje që e krijoi kombin shqiptar. Ajo përfshin katër faza të zhvillimit: Faza e parë, vitet 30 të shek. XIX-1878; faza e dytë 1878-1881; faza e tretë 1881-1908; dhe faza e katërt 1908-1912.

Faza e parë, e cila nis në vitin ‘30 të shek. XIX dhe vazhdon deri në vitet e Krizës Lindore (1876-1878), paraqet periudhën e ndryshimeve të rëndësishme në jetën ekonomiko-shoqërore, politike e kulturore dhe të konsolidimit të entitetit shqiptar. Në këtë periudhë fillon formësimi i mendimit politik të Rilindjes dhe i programit të saj. Përpjekjet për afirmimin e kombit shqiptar u shoqëruan me ngritjen e nivelit të kulturës kombëtare, që u arrit përmes aktivitetit në kolonitë e shumta, por edhe brenda hapësirës shqiptare. Në këtë fazë të Rilindjes u formulua edhe kërkesa e organizimit autonom të trojeve shqiptare. Faza e parë karakterizohet nga një varg kryengritjesh të popullsisë që shpërthyen në vitet ‘30-‘40 dhe që vazhduan deri më 1878. Protagonistë kryesorë të kësaj faze u bënë intelektualë, klerikë e mësues të shkolluar

kryesisht në vendet e Europës Perëndimore, por edhe shoqëri e komitete kombëtare të kolonive, si të arbëreshëve në Itali, pastaj në Stamboll, Bukuresht, Sofje, Misir dhe në vende të tjera. Ata gradualisht përpunuan idetë për të drejtat e kombit shqiptar, i pasuruan ato me ide iluministe për shkollën dhe gjuhën shqipe dhe në përgjithësi për kulturën kombëtare. Edhe kërkesat për zhvillim ekonomik të Shqipërisë ishin në themel të këtyre koncepteve zhvillimore.

Faza e dytë e Rilindjes Kombëtare përfshin vitet 1878-1881, periudhën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Në kohën e Lidhjes, rilindësit përpunuan një program të plotë politik për mbrojtjen e tërësisë territoriale të Shqipërisë dhe për bashkimin e të gjitha vilajeteve shqiptare në një shtet autonom. Kjo ishte kohë e përpunimit të kërkesave politike, territoriale e administrative, si fazë kalimtare drejt pavarësisë së plotë nga Perandoria Osmane. Epoka e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit nxori në sipërfaqe personalitete të shquara e udhëheqës politikë e ushtarakë, si: Abdyl Frashëri, Ymer Prizreni, Sylejman Vokshi, Iljaz Pashë Dibra, Mic Sokoli, Mehmet Vrioni etj. Nën drejtimin e Lidhjes së Prizrenit u bë përpjekja e parë politike, ushtarake e diplomatike për të themeluar shtetin kombëtar shqiptar. Në këtë fazë u sensibilizua diplomacia e Fuqive të Mëdha me kërkesat politike të shqiptarëve. U krijua gjendja e dypushtetit. Shqiptarët formuan institucionet e tyre të pavarura, si qeverinë e përkohshme, ushtrinë, gjyqet vendore, komisionin për punë të jashtme, komisionin e financave etj. Në këtë fazë u mbajt Kongresi i Berlinit dhe filloi copëtimi i territoreve shqiptare. Përmes memorandumeve, kërkesave dhe protestave dërguar qeverive të Fuqive të Mëdha dhe shteteve ballkanike, shqiptarët kundërshtuan vendimet e Kongresit të Berlinit. Në fund të kësaj faze (1881) u shua Lidhja e Prizrenit dhe u përndoqën dhe u dënuan ideologët e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare.

Faza e tretë e Rilindjes përfshin vitet 1881-1908. Në këtë periudhë Lëvizja Kombëtare Shqiptare vjen duke u rritur nga pikëpamja cilësore dhe nga organizimi i saj. Pas shtypjes së Lidhjes së Prizrenit u hodhën themelet e shkollës kombëtare, u zhvillua letërsia shqipe, u zgjerua publicistika shqiptare. Bartës të këtyre zhvillimeve u bënë shkrimtarë, studiues, mendimtarë e publicistë, që krijuan vepra nga

më të ndryshmet. Në këtë periudhë zgjerohet më tej veprimtaria patriotike e kolonive shqiptare të mërgimit, që dhanë kontribut të çmuar në lëvizjen kombëtare. Vitet e fundit të shek. XIX shënuan një ngritje të re të lëvizjes për autonominë e Shqipërisë, që u përcoll me formimin e Lidhjes së Pejës (1899-1900) të udhëhequr nga Haxhi Zeka. Themelimi i komiteteve “Për lirinë e Shqipërisë” dhe veprimtaria e tyre (1905-1908) ishte dëshmi e ngritjes së mëtejshme të shkallës së organizimit të lëvizjes kombëtare në këtë fazë.

Fillimi i fazës së katërt (1908-1912) është i lidhur me fitoren e Revolucionit xhonturk. Kjo është periudha e rritjes së lëvizjes politike-kulturore (1908-1910) dhe e kryengritjeve të mëdha shqiptare kundër sundimit osman (1910-1912). Kryengritjet, sidomos ajo e përgjithshme e vitit 1912, përgatitën terrenin për shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë, me të cilën mbyllet epoka e Rilindjes Kombëtare. Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë ishte akti më i rëndësishëm në të gjithë periudhën e Rilindjes Kombëtare. Epokës së pavarësisë i kontribuuan intelektualë, politikanë, diplomatë, mendimtarë, tribunë e udhëheqës popullor, si: Ismail Qemali, Hasan Prishtina, Luigj Gurakuqi, Bajram Curri, Isa Boletini, Idriz Seferi etj. Shteti i pavarur shqiptar nuk arriti t'i bashkojë në një shtet të gjitha trojet e Shqipërisë, pjesa më e madhe e të cilave, me vendimin e Konferencës së Ambasadorëve në Londrës, mbeti nën sundimin e shteteve fqinje, të Serbisë, të Malit të Zi dhe të Greqisë. Me vendimet politike që u morën nga faktori i jashtëm, çështja shqiptare e mbështetur në idetë dhe platformën e Rilindjes Kombëtare Shqiptare u la e pazgjidhur për një kohë të gjatë. (Frashër Demaj)

RINDËRTIMI I PASLUFTËS. U referohet zakonisht ndërhyrjeve vendore dhe ndërkombëtare për të evituar pasojat e luftërave dhe të konflikteve. Një nga ndërmarrjet më vëllimore të rindërtimit ka ndodhur pas Luftës së Dytë Botërore, për rindërtimin e Europës, e veçanërisht të Gjermanisë, që njihet me emrin “Plani Marshall”. Periudha e rindërtimit zakonisht përcillet me përfshirje të gjerë të organizatave qeveritare, joqeveritare, të organizatave humanitare, të institucioneve financiare ndërkombëtare, sidomos të Bankës Botërore dhe të agjencisë së saj për zhvillim

ndërkombëtar. Ndërhyrjet përfshijnë që nga ndihmat në ushqime e shëndetësi e deri te strehimi, infrastruktura, shërbimet publike etj. Pas kësaj vijnë ndërhyrjet për konsolidimin e ekonomisë dhe krijimin e kushteve për zhvillim ekonomik. Edhe Kosova pas luftës, sidomos në vitin 1998 dhe 1999 dhe pas çlirimit të vendit, u ballafaqua me nevojën e ndërhyrjeve substanciale në fushën humanitare, sociale dhe ekonomike për ta rindërtuar vendin. Angazhimet në rindërtim u morën përsipër nga UNMIK-u, por edhe nga shtetet e veçanta, si SHBA-ja dhe shtetet e Bashkimit Europian, nëpërmjet Agjencisë Europiane për Rindërtim apo nga vendet europiane veç e veç, pastaj nga organizatat humanitare e fetare etj. Llogaritet se bashkësia ndërkombëtare investoi mbi 2 miliardë euro në 4-5 vitet e para për rindërtimin e Kosovës. Në periudhën e rindërtimit me rëndësi ishte edhe angazhimi i vetë qytetarëve, që me forcat e veta të rindërtojnë shtëpitë e tyre dhe të rifillojnë aktivitetet ekonomike pas kthimit në vend të më tepër se gjysmës së popullatës së deportuar gjatë muajve të luftës. Solidariteti i diasporës ka qenë i një rëndësie themelore për rindërtimin efikas dhe evitimin relativisht të shpejtë të pasojave më të vrazhda të luftës, kryesisht në fushën e banimit, të infrastrukturës dhe të shërbimeve publike. Pas fazës emergjente, rindërtimi ekonomik dhe konsolidimi i ekonomisë, veçmas i sektorëve të prodhimit e pastaj edhe i sistemit arsimor e shëndetësor në Kosovë ende ballafaqohet me shumë probleme dhe ngecje. Financimi i rindërtimit përgjatë fazës emergjente bëhet kryesisht me donacione e grante, ndërsa pas periudhës 3-4 vjeçare financimet u bënë më shumë nga marrëdhëniet kreditore dhe kreditimi, sidomos nga Banka Botërore, por edhe nga bankat tregtare dhe komerciale. Në rast se këto hua nuk shfrytëzohen mirë, vendi mund të ballafaqohet me stërngarkim të borxheve të jashtme dhe me krizë serioze ekonomike. (Muhamet Mustafa)

RIPUSHTIMI I KOSOVËS (1918). Derisa po përfundonte Lufta e Parë Botërore në vjeshtë të vitit 1918 dhe shihej qartë kapitullimi i Fuqive Qendrore, Serbia iu përvesh luftës propagandistike, duke shpërndarë me aeroplanë 5,000 proklamata në gjuhën serbe dhe turke në rrethet e Kumanovës, Prishtinës, Kaçanikut, Mitrovicës dhe Pazarit të Ri, duke i ftuar

shqiptarët që të ngrihen në kryengritje kundër bullgarëve, gjermanëve dhe austriakëve. Për dëgjueshmëri, qeveria serbe premtonte: “Do të bëhemi prapë miq të mirë!”. Në fund të shtatorit dhe në fillim të tetorit 1918, në Kosovë e para hyri ushtria franceze si aleate. Forcat franceze e morën Kosovën deri nga mesi i tetorit të vitit 1918, ndërsa bashkë me to u dërguan zyrtarë nga qeveria serbe për ta organizuar pushtetin policor. Qeveria e Beogradit përpigjeq që, krahas depërtimit të ushtrisë franceze, të organizohej pushteti serb nëpër qendrat më të mëdha administrative. Forcat franceze sapo hynë në Kosovë deklaruan se do të merrnin pjesë vetëm në ndjekjen e ushtrisë austro-hungareze, ndërsa çështja e pushtetit, si kurorëzim i luftës për çlirim, mbetej çështje e shqiptarëve. Kjo nuk ndodhi kështu, sepse ushtria franceze ia dorëzoi Kosovën ushtrisë serbe. Në këtë periudhë çetat shqiptare u aktivizuan, sidomos pas shpërthimit të frontit të Selanikut dhe humbjeve të ushtrisë austro-hungareze. Në këtë situatë, më 12 tetor 1918, në Pejë hynë së bashku Kostë Peçanci dhe Azem Bejta me kryengritësit, si çlirimtarë të qytetit. Francezët dhe serbët në territorin e Kosovës nuk zhvilluan asnjë betejë kundër ushtrisë austro-hungareze, gjermane ose bullgare. Çetat shqiptare me luftën e tyre i detyruan disa njësitë ushtrisë austro-hungareze që të kapitullonin para tyre. Megjithatë, francezët i dhanë përkrahje ushtrisë serbe si aleate që të vendosë pushtetin e vet në Kosovë. Por shqiptarët këtë ripushtim të territoreve nuk e pranuan, prandaj çetat shqiptare anëmbanë Kosovës u organizuan në luftë kundër pushtimit serb. Rezistenca e shqiptarëve kundër vendosjes së pushtetit serb nga mesi i tetorit 1918 u intensifikua. Në nëntor të po atij viti, Serbia filloi çarmatosjen e shqiptarëve dhe brenda një periudhe të shkurtër ky aksion përfshiu të gjithë territoret shqiptare që mbetën nën sundimin serb. Pushteti serb i filloi edhe ndjekjet kundër prijësve shqiptarë, të njohur edhe më parë si luftëtarë të lëvizjes kombëtare shqiptare. Për të shpëtuar, disa prej tyre u detyruan të largohen nga territori i Kosovës. Pjesa më e madhe shkuan në Shkodër, kurse disa të tjerë në vende të ndryshme të Shqipërisë dhe të Europës. Pas Luftës së Parë Botërore, Mbretërisë Serbe-Kroate-Slllovene rivendosi në Kosovë një regjim terrori dhe eksploatimi. Shqiptarëve, për dallim nga gjermanët, hungarezët, slllovakët etj., nuk

iu njoh as e drejta e pakicës kombëtare. Atyre nuk iu mbeti rrugë tjetër, pos vazhdimi të rezistencës edhe për disa dekada. (Lush Cula)

RISKU (I VENDIT). Një tërësi e rreziqeve të lidhura me investimin në një vend të huaj, të cilat mund të përfshijnë ndryshime në ambientin e biznesit dhe që mund të ndikojnë negativisht në fitimet ose në vlerën e asetëve të firmës. Këto rreziqe mund të përfshijnë rreziqe politike dhe ato financiare. Rreziqet politike kryesisht janë të lidhura me veprimet e qeverisë së vendit pritës, të cilat mund të përfshijnë luftëra, bllokime të fondeve, moskonvertueshmëri të valutës, ndryshime të papritura të politikave tatimore ose ligjeve, si dhe probleme të tjera që lidhen me sundimin e ligjit. Rreziqet financiare mund të përfshijnë zhvillimet e paparashikueshme të normave të interesit, inflacionin, kursin e këmbimit, konkurrencën si dhe rritjen ekonomike. Agjencitë e vlerësimit të rrezikut të vendit përdorin metodologji të ndryshme vlerësimi. Një metodë ka të bëjë me gjykimin e të gjithë faktorëve politikë dhe financiarë, që kontribuojnë në vlerësimin e rrezikut të vendit. Përdorimi i analizës sasiore ose regresioneve të ndryshme ekonometrike për të identifikuar karakteristikat që ndikojnë mbi nivelin e rrezikut të një vendi paraqesin një tjetër metodë të rëndësishme. Agjencitë e vlerësimit po ashtu aplikojnë vizita inspektuese në një vend dhe takime me zyrtarë të qeverisë, drejtues biznesi dhe të tjerë për të arritur deri te informacionet relevante për vlerësimin e rrezikut të një vendi. Për Kosovën ky tregues nuk është publikuar, megjithatë perceptimi mbi riskun e investimit në Kosovë në aspektin ekonomik nuk dallon shumë nga vendet e rajonit, në sajë të stabilitetit fiskal dhe financiar, edhe pse ka ndikime negative të aspekteve politike. (Sokol Havolli)

RISTIQ (Ristić) Lubomir (1932-). Mjek, gjinekolog, obstetër, profesor universiteti. Lindi në Shkup, ku kreu arsimimin fillor dhe të mesëm. Studimet i përfundoi në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Shkupit (1959). Zë punë në Spitalin e Përgjithshëm në Prishtinë, specializoi për gjinekologji me obstetrikë, ndërsa me hapjen e Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë u angazhua si asistent i gjinekologjisë dhe shef reparti në këtë klinikë. Mbrojti tezën e disertacionit të doktoratës në Fakultetin e

Mjekësisë në Prishtinë (1978), më pas i arriti të gjithë titujt universitarë për mësim në gjuhën serbe. Është autor i një sërë punimesh profesionale dhe shkencore të botuara brenda dhe jashtë vendit. Në vitin 1990, pas aplikimit të masave të dhunshme në shëndetësinë e Kosovës, u caktua drejtor në Klinikën e Gjinekologjisë dhe largoi nga puna gjithë kuadrin shqiptar. U identifikua si zbatues i politikës së Millosheviqit në shëndetësinë e Kosovës. Pas vitit 1999 u largua nga Kosova dhe punoi në Beograd. (Binak Kastrati)

RISTIĆ (Ristić) Miomir (1932-). Mjek internist, reumatolog, profesor universiteti. Lindi në Prizren, ku kreu shkollën fillore dhe të mesme, studimet në Fakultetin e Mjekësisë në Beograd (1967) dhe specializimin nga mjekësia interne gjithashtu në Beograd. Tre vjet më vonë përfundoi subspecializimin nga reumatologjia dhe ishte reumatologu i parë në Kosovë. Pas specializimit punoi në Klinikën Interne të Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë. Ishte shef reparti për shumë vjet. Mbrojti tezën e disertacionit të doktoraturës në Universitetin e Shkupit (1970). Në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë i mori të gjithë titujt universitarë, nga asistenti e deri te profesori ordinar. Është autor i një sërë punimesh shkencore dhe profesionale nga lëmi i reumatologjisë dhe endokrinologjisë. (Ahmet Brovina)

RISTRUKTURIMI. Një veprim korporativ, përmes të cilit ndryshohet struktura organizative, operacionale, pronësore apo struktura e borxhit të një ndërmarrjeje. Qëllimi parësor i ristrukturimit është që ta bëjë ndërmarrjen më fitimprurëse apo ta organizojë atë në mënyrë që t'u përshtatet rrethanave të reja të tregut. Ristrukturimi zakonisht bëhet në rastet kur ndërmarrja ka vështirësi, të cilat krijojnë trysni në mbarëvajtjen e veprimtarisë së ndërmarrjes apo rrezikojnë ekzistencën e saj. Ristrukturimi i ndërmarrjeve në Kosovë është një dukuri e re dhe në mënyrë më domethënëse është përdorur vetëm në kontekst të riorganizimit të ndërmarrjeve publike gjatë administrimit të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit. (Alban Hashani)

RIZA Emin (1937-). Inxhinier i ndërtimit, restaurator, studiues i trashëgimisë arkitekturale. Lindi në Korçë, shkollimin bazë e kreu



EMIN RIZA

në vendlindje, ndërsa studimet për inxhinieri ndërtimi i mbaroi në Universitetin e Tiranës (1962). Nga ky vit e deri në muajin shkurt të vitit 2008 punoi në Institutin e Monumenteve në Tiranë, me përjashtim të periudhës 1993-1997, kur ishte i ngarkuar me detyrën e sekretarit shkencor të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (ASHSH). Nga viti 2009 ishte kryetar i seksionit të shkencave shoqërorë dhe albanologjike të ASHSH-së. Ka fituar gradat dhe titujt shkencorë: kandidat i shkencave, bashkëpunëtor i vjetër shkencor, doktor i shkencave dhe profesor në vitin 1995. Në vitin 2009 u zgjodh anëtar i jashtëm i ASHAK-ut, ndërsa në vitet 2009, përkatësisht 2011, u zgjodh anëtar i asociuar dhe anëtar i ASHSH-së. Për disa vjet ishte kryeredaktor i revistës “Monumentet” dhe “Studia Albanica.” Ka zhvilluar veprimtari të dendur në fushën e restaurimit të monumenteve të arkitekturës. Është bashkëhartues i dy dosjeve për vlerësimin e qendrave historike të Gjirokastrës dhe të Beratit, për t'u përfshirë në trashëgiminë botërore nga UNESCO, si dhe autor dhe bashkautor i disa monografive: “Qyteti-muze i Gjirokastrës” (1980), “Teoria dhe praktika e restaurimit të monumenteve të arkitekturës” (2002), “Vendbanime dhe banesa popullore shqiptare” (2004), “Banesa qytetare kosovare e shek. XVIII-XIX” (2006), “Qyteti dhe banesat shqiptare të shek. XV-XIX” (2009), “Berati, historia dhe arkitektura” (2014) etj. Ka botuar artikuj të shumtë dhe punime shkencore në periodikun profesional brenda dhe jashtë vendit. (Fejaz Drançolli)

RIZA Faik (1928-1998). Lindi në Gjakovë. Shkollimin fillor e kreu në vendlindje, të mesmen në Prishtinë (1941). Ishte pjesëmarrës i demonstratave kundër mbylljes së gjimnazit në Gjakovë, për çka ishte i përndjekur politik dhe i burgosur. Kreu studimet në Fakultetin e Bujqësisë të Universitetit të Beogradit (1954). Për shkak të aktivitetit politik burgoset dhe vuan dënimin në Goli Otok. Pas burgut punësohet në Kombinatin e Duhanit në Gjakovë. Kalon me detyrë në Prishtinë, në Lidhjen e Kooperativave Bujqësore e më vonë në Bankën Bujqësore në Prishtinë dhe në

Bankën e Kosovës, ndërsa më vonë në Odën Ekonomike të Kosovës zv/drejtor (1956). Punoi zëvendësdrejtor në Bankën Investive të Kosovës (1974). U mor me përkthime të teksteve shkollore dhe universitare. (Agim Zajmi)

RIZA Selman (1909-1988). Gjuhëtar, profesor. Lindi në Gjakovë. Shkollimin fillor e mbaroi në vendlindje dhe në Tiranë. Kreu Liceun e Korçës, ndërsa studimet për letërsi i vazhdoi në



SELMAN RIZA

Universitetin e Tuluzës, Francë. Në të njëjtën kohë i mbaroi edhe studimet për jurisprudencë. U emërua profesor në Liceun e Korçës për gjuhët shqipe, frënge, latine dhe gjermane. Më 1939 përfshihet në veprimtari kundër pushtimit italian, ndërsa më 28 nëntor 1939 merr pjesë në demonstratën e madhe, bashkë me figura të njohura, si A. Ermenji, S. Skendi, E. Hoxha etj. Më 1940 transferohet në Liceun e Tiranës, por shpejt e largojnë. Ishte i burgosur dhe i internuar në Ventotene në Itali për 20 muaj. I ndalua edhe puna në arsim për arsye politike. Më 1943 vendoset në Prizren, ku punoi si avokat dhe zhvilloi veprimtari patriotike. Ishte në grupin që krijoi Qendrën e Vogël të Studimeve Kosovare, me degët në Gjakovë, Pejë, Prishtinë, Mitrovicë. U vu në krye të Lëvizjes Antifashiste Irredentiste për pjesën politike, ndërsa pjesën ushtarake e drejtonte Ejup Binaku. Bashkë me anëtarët e Komitetit Intelektual Shqiptar bontonte gazetën "Lidhja e Prizrenit". Në fund të vitit 1944, S. Riza u kthye në Tiranë, ndërsa në janar të vitit 1945 u burgos nga pushteti komunist. U mbajt në burg pa gjyq për tre vjet dhe më 1948 iu dorëzua Jugosllavisë, me akuzën "kriminel luftë". Në burgun e Prishtinës u mbajt pa vendim gjykate deri më 1951, kur u internua në Sarajevë. Atje iu lejua të punonte si lektor i frëngjishtes në universitet. Më 1953 u kthye në Prishtinë dhe u caktua punëtor shkencor në Institutin Albanologjik. Në dhjetor të vitit 1955 u mbyll Instituti Albanologjik dhe S. Riza u deportua në Shqipëri. Në Tiranë u caktua të punonte në Institutin e Shkencave, si punonjës shkencor dhe profesor deri më 1967. Më 1959 mbrojt gradën kandidat i shkencave, ndërsa më 1961 mori gradën profesor. Më 1962 i jepet

Universitetin e Tuluzës, Francë. Në të njëjtën kohë i mbaroi edhe studimet për jurisprudencë. U emërua profesor në Liceun e Korçës për gjuhët shqipe, frënge, latine dhe gjermane. Më 1939 përfshihet në veprimtari kundër push-

Çmimi i Republikës. Më 1967, në kohën e ndikimeve politike të Revolucionit Kulturor, u akuzua për "shfaqje të huaja e armiqësore dhe për pikëpamje të papranueshme". Pas një fushate fletërrufesh, u largua nga puna dhe u internua në Berat, ku punoi si ciceron në muzeun lokal dhe më pas në bibliotekë. Ishte njohës shumë i mirë i gramatikës, si asaj diakronike, ashtu edhe i asaj sinkronike. Dha kontribut për studimin e nyjave të shqipes, të emrave, mbiemrave, përemrave dhe sistemit foljor. Bëri studime të autorëve të vjetër: Buzukut, Matrëngës, Budit, Bardhit dhe Bogdanit. Për shqipen standarde ishte mbështetës i "pangegërishtes". Ndër studimet kryesore të tij janë: "Tri monografina albanologjike" (Tiranë, 1944), "Fillimet e gjuhësisë shqiptare" (Prishtinë, 1952), "Gramatikë e sërbo-kroatishes" (Prishtinë, 1952), "Pesë autorët më të vjetër të gjuhës shqipe" (Tiranë, 1960) dhe "Sistemi foljor i letrarishtes shqiptare bashkëkohore", botuar pas vdekjes (Tiranë, 1995). Pas internimit në Berat nuk ka pasur të drejtë botimi. Një pjesë e veprës së tij u publikua në Prishtinë në vëllimin "Studime albanistike I" më 1979. Vepra e tij u botua në pesë vëllime me titullin "Vepra I-V" nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës. Pas rënies së komunizmit ka pasur interesim të shtuar të studimeve për S. Rizën, me ç'rast janë mbajtur disa sesione shkencore. (Bardh Rugova)

RIZA Ymer (1885-1961). Instrumentist popullor. Lindi në një familje qytetare të Gjakovës. Që në fëmijëri ishte i dhënë pas muzikës. Dallohej për mjeshtërinë e ekzekutimit në sharki. Ishte një figurë e shquar, që dha kontribut për këngën qytetare gjakovare. Sharkia ishte bërë pjesë e pandashme e jetës së tij. Përveç themelimit të grupit të tij muzikor më 1930, punoi me ngulm edhe për kultivimin e këngës qytetare. Ka dhënë kontribut në zbulimin e talentëve të rinj, duke gjallëruar lëvizjen artistike në qytet dhe më gjerë. (Krenar Doli)

RIZAJ Gazmend (1958-). Historian, profesor universiteti. Lindi në Pejë. Kreu studimet për histori në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës (UP). Mbaroi studimet pasuniversitare në Universitetin e Sarajevës, ndërsa u doktorua në Fakultetin Filozofik të UP-së (1995). Nga viti 1981 punoi në Muzeun e Revolucionit të Kosovës, si bashkëpunëtor i lartë profesional, ku ishte autor dhe kurator i shumë ekspozitave



GAZMEND RIZAJ

e historisë dhe në Fakultetin Filozofik të UP-së kreu detyra dhe funksione të ndryshme. Për disa vjet ishte edhe pedagog i jashtëm në Universitetin e Tetovës. Kreu specializime post-doktorale në Itali për gjeografi historike dhe në SHBA për civilizimin amerikan (2001-2004). Është pjesëmarrës i një sërë konferencash shkencore, si dhe autor i një sërë punimesh shkencore të botuara brenda dhe jashtë vendit. Është autor i tekstit universitar “Gjeografi historike dhe hartografi” (2007) dhe i monografisë “Shqipëria e Sipërme në projektet dhe traktatet e Fuqive të Mëdha dhe të shteteve ballkanike 1800-1913” (2011). (Sadik Mehmeti)

RIZAJ Musa (1953-). Inxhinier i metalurgjisë, profesor universiteti. Lindi në Prekolluk të Deçanit. Shkollën fillore dhe gjimnazin i përfundoi në vendlindje, studimet në Fakul-



MUSA RIZAJ

tetin Teknik të Universitetit të Prishtinës (UP) (1977), ndërsa studimet pasuniversitare në Fakultetin e Metalurgjisë të Universitetit të Beogradit (1987). Tezën e disertacionit të doktoratës e mbrojti në Fakultetin e Xehetarisë dhe të Metalurgjisë të UP-së (1998). Ka punuar në shkriptoren “Ferronikeli” të Drenasit (1977-1988) në postin e drejtorit teknik. Ishte i inkuadruar dhe në procesin mësimor në Fakultetin e Xehetarisë dhe të Metalurgjisë, ku i arrin të gjithë titujt universitarë. Është autor dhe bashkautor i shumë punimeve shkencore dhe profesionale, të publikuara në revistat shkencore brenda dhe jashtë vendit. Është autor i tekstit universitar “Termoinxhinieria në metalurgji” (2009) dhe i disa dispensave. Ushtrroi një sërë funksionesh dhe detyrash me përgjegjësi në fakultetin ku punon dhe në organet drejtuese të UP-së. Mori pjesë në simpoziume dhe konferenca

shkencore vendore dhe ndërkombëtare. (Avni Terziqi)

RIZAJ Skënder (1930-). Historian medievallist e osmanolog, profesor universiteti. Lind në Pejë, ku kreu shkollën fillore, në Prizren kreu Shkollën Normale, ndërsa studimet për histori i



SKËNDER RIZAJ

mbaroi në Universitetin e Shkupit (1956). Studimet pasuniversitare dhe të doktoratës i kreu në Universitetin e Sarajevës (1965). Ishte burgosur në moshë të mitur për aktivitetin e tij në grupin nacionalist të drejtuar nga Marije Shllaku e Bernard Llupi (1946). Karrierën edukative-pedagogjike e nisi si mësues në Pejë e rrethit (1948-1952) dhe më pas si mësues në gjimnazin të Pejës (1956). Më 1961 nisi punë në Arkivin e Kosovës dhe më pas në degën e historisë të Fakultetit të Filozofisë në Prishtinë, ku punoi deri në vitin 1987. Ndërkohë bëri studime specializuese postdoktorale dhe hulumtime sistematike arkivore. Është autor i disa monografive shkencore, veçmas për periudhën osmane, si: “Xehetaria në Kosovë nga shek. XV-XVII” (1968), “Kosova gjatë shekujve XV, XVI dhe XVII” (1982), “Lidhja Shqiptare e Prizrenit 1877-1885” (1998), “Gazetat turke dhe amerikane për gjenocidin serb ndaj shqiptarëve” (1999), “Falsifikimet e historiografisë serbe” (2006), “Vilajetet shqiptare-Vilajeti i Kosovës (1864-1912)” (2008) etj. Është autor i tekstit universitar “Historia e përgjithshme, Koha e re I, 1453-1789” (1985), si dhe i disa teksteve për shkollat fillore. Ka botuar edhe disa vëllime dokumentesh nga arkivat turke dhe britanike: “Lidhja Shqiptare e Prizrenit në dokumente angleze 1878-1881” (1978), “Dokumente angleze mbi Lidhjen Shqiptare të Prizrenit dhe fillimi i copëtimit të Ballkanit (1877-1885)” etj. Nga punimet e tij shkencore kanë tërhequr vëmendjen studimet “Mbi të ashtuquajturën dyndje e madhe serbe nga Kosova në krye me patrikun Arsenije Çarnojeviq, 1690”, botuar më 1983 në Prishtinë dhe “Përppjekja e kosovarëve për t’u çliruar në vitet 1689-1690”, botuar në Tiranë në të njëjtin vit. Është pensionuar para kohe, me urdhrin e pushtetit të atëhershëm (1987). Është bartës i një sërë mirënjohjesh dhe dekoratash. (Jahja Drançolli)

RIZVANOLLI Esat (1936- 2006). Kompozitor. Lindi në Gjakovë. Kreu Shkollën e Mesme të Muzikës në Prizren (1954). Një kohë punoi në Gjakovë. Fillimisht studioi në drejtimin



ESAT RIZVANOLLI

teoriko-pedagogjik, më pas vazhdoi në atë të kompozimit në Akademinë së Muzikës në Beograd. Pas një periudhe pune prej redaktori të muzikës popullore në Radiotelevizionin e Prishtinës, kreu studimet pasuniversitare në Konservatorin e Moskës, te prof. A. Semyonoviç-Lehman (1983-1985). Pas kthimit nga Moska vazhdoi punën në RTV Prishtina, ndërsa nga viti 2000 në degën e muzikës të Fakultetit të Arteve të Universitetit të Prishtinës, ku ishte pedagog i solfezhit. Ishte anëtar i Shoqatës së Kompozitorëve të Kosovës dhe të ish-Jugosllavisë. Opusi i tij krijues përbëhet nga vepra të formave dhe gjinive të ndryshme muzikore, midis të cilave shquhen veprat korale: “Shtigjet tona”, “Madrigal” (1961), “Xehtarëve”, “N’mjedis ballit ma ke një pikë”, “Abdyl shite pasurinë”, për kor të përzier; pastaj këngë solo për zë e piano: “Peshkatarin” (1960); veprat pianistike: “Suita dasmore” (1960), Adagio dhe Scherzo (1961), Rondo rustico (1961), Temë me 7 variacione (1962), “Valle e rëndë”, “Praeludium” (1996); veprat solistike dhe kamerale: fuga me katër variacione, violinë e piano (1961-62), Kuarteti harkor (1963); veprat vokalo-instrumentale: “Fjala e Skënderbeut” për recitator, bariton, kor e orkestër (1968), “Rezistenca 1943” për kor e orkestër (1973); Veprat orkestrale: poema simfonike (1974), Musica simfonica (1977), Koncert për violinë e orkestër (1985), Koncert për violë e orkestër (1999). Veprat e tij janë interpretuar në koncerte e qendra të tjera të ish-Jugosllavisë, në festivale të ndryshme në Kosovë dhe në vende të tjera. (Rreze Kryeziu-Breznica)

RIZVANOLLI Fatmir (1937-2000). Inxhinier i xehetarisë. Lindi në Gjakovë. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Gjakovë, studimet në Fakultetin e Xehetarisë dhe të Gjeologjisë në Universitetin e Beogradit (1962). Fillimisht punoi në minierën e kromit “Deva” në Gjakovë (1962-1966) si inxhinier, më pas në minierat Hajvali-Kishnicë (1967-1971) si

udhëheqës i investimeve. Nga viti 1972 bëhet drejtor i mihjes sipërfaqësore të minierës së qymyrit “Mirash” në Obiliq në kuadër të kombinatit xehetar-energjetik “Kosova”. Kreu një varg funksionesh të tjera udhëheqëse. Ishte pjesëmarrës në disa kongrese dhe konferenca shkencore nga lëmi i xehetarisë në vend dhe jashtë. (Shyqeri Kelmendi)

RIZVANOLLIFuat (1932-). Matematikan, profesor universiteti. Lindi në Gjakovë, ku kreu shkollën fillore dhe gjimnazin e ulët, ndërsa shkollën e mesme e kreu në Prishtinë. U diplomua në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore (FSHMN) të Universitetit të Beogradit (1961). Punoi asistent në Fakultetin Juridik-Ekonomik në Prishtinë (1962-1967). Studimet pasuniversitare dhe tezën e disertacionit e mbrojti në FSHMN po në Universitetin e Beogradit (1982). Ligjëroi lëndë nga matematika për ekonomistë (1968-1986), më pas zgjidhet profesor dhe ligjëroi kurse të ndryshme në studimet themelore e pasuniversitare në departamentin e matematikës të FSHMN-së, në Fakultetin Teknik të Universitetit të Prishtinës dhe në Universitetin e Europës Juglindore në Tetovë. Ka bërë specializime të ndryshme dhe ka marrë pjesë në tubime shkencore të matematikanëve. Ka publikuar punime shkencor dhe tekstin universitar të matematikës për studentët e Fakultetit Ekonomik. Ka kryer detyra me rëndësi në institucionet e arsimit të lartë. (Minir Efendija)

RIZVANOLLI Masar (1933-). Historian, profesor universiteti. Shkollën fillore dhe normalen i kreu në Gjakovë, ndërsa studimet për histori i vijoi në Fakultetin Filozofik të Universitetit të



MASAR RIZVANOLLI

Beogradit, ku u diplomua në vitin 1961. Studimet pasuniversitare i kreu në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës, ku mbrojti edhe temën e disertacionit (1990). Në fillim punoi mësues në Shtime, ndërsa më pas ishte mësimdhënës në gjimnazin “Hajdar Dushi” në Gjakovë, dhe në Shkollën Teknike në Gjakovë. Ishte njëri ndër themeluesit e Shkollës së Lartë Pedagogjike në Gjakovë dhe më vonë drejtor i saj. Pas Plenumit të Brionëve u

zgjodh deputet i Dhomës Kulturore Arsimore të Kuvendit të Kosovës. Në periudhën 1977-2003 ishte ligjërues dhe profesor në katedrën e historisë në Fakultetin Filozofik të Prishtinës. Shkroi një sërë punimesh shkencore për periudha të ndryshme historike. Botoi veprat: “Lufta e Serbisë dhe e Malit të Zi për pushtimin e tokave shqiptare gjatë Krizës Lindore 1875-1878” (2007), “Çarshia e Madhe e Gjakovës” (2009) etj. Mori pjesë në konferenca dhe simpoziume shkencore, brenda dhe jashtë vendit. (Frashër Demaj)

ROBAJ Shpëtim (1957-1998). Mjek, anesteziolog, dëshmor. Lindi në Prizren. Kreu arsimin fillor dhe të mesëm në Prishtinë, ndërsa studimet në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë



SHPËTIM ROBAJ

(1982). Fillimisht punoi në Shtëpinë e Shëndetit në Drenas. Specializimin nga anesteziologjia me reanimim e vazhdoi në Universitetin e Zagrebit, të Rijekës dhe të Shkupit. U emërua asistent për lëndën e kirurgjisë në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. Në vitin 1991, bashkë me kuadrin shqiptar u përjashtua nga puna. Filloi punën në poliklinikën private “Galaksia”, duke vazhduar ushtrimet me studentë në Fakultetin e Mjekësisë. Pas fillimit të luftës në Kosovë, Sh. Robaj ishte ndër vullnetarët e parë nga radhët e mjekëve specialistë, të cilët operuan në zonat e luftës, duke i ardhur në ndihmë popullsisë civile dhe ushtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ai ishte organizatori kryesor i ekipëve të specialistëve nga Prishtina, që shkuan në Drenicë dhe në zona të tjera të luftës. Sh. Robaj u vra rrugës mes Abrisë dhe Likocit, më 30 shtator 1998. (Osman Sejfi)

ROBELLI Enver (1973-). Gazetar, përkthyes. Lindi në Lajçiq të Kamenicë. Shkollimin fillor e kreu në vendlindje, shkollën e mesme në Zvicër, studimet në Institutin e Gazetarisë në Lucern (Zvicër). Punoi redaktor i politikës së jashtme në gazetën zvicerane “Tages Anzeiger” që nga viti 2001. Në periudhën 2007-2012 punoi korrespondent për Europën Juglindore i gazetave “Tages Anzeiger” dhe “Süddeutsche Zeitung”. Që nga viti 1997 shkruan tekste të ndryshme për përditshmen “Koha ditore”. Bashkëpunoi edhe me gazetën “Frankfurter Allgemeine



ENVER ROBELLI

Zeitung”, “Tagesspiegel” (Berlin), me Radion Publike të Zvicrës dhe me Televizionin Publik të Austrisë. Në vitet 1997-1999 punoi në departamentin e politikës së jashtme të Televizionit Publik të Zvicrës. Përveç punës si gazetar, merret edhe me përkthime nga gjermanishtja. Botoi të përkthyer librat: “Kosova, histori e shkurtër e një treve qendrore ballkanike” të Oliver Jens Schmitt dhe “Angela Merkel: Kancelarja dhe bota e saj” të Stefan Kornelius. Është autor i librit-intervistë “Arbën Xhaferi rrëfen. Në Tetovë, në kërkim të kuptimit”. (Nehat Islami)

RODIQI Matej (1929-). Pikturor, disenjator grafik. Lindi në Prizren. Kreu Akademinë e Arteve Aplikative në Beograd (1954). Studimet e formësimit industrial i kreu në Venecia më



MATEJ RODIQI

1964. Ishte artist i lirë në Beograd, ku pati një aktivitet të gjerë në fushën e dizajnit grafik, në pikturë, tapiceri dhe në tekstil. Për disa vjet ishte profesor i lëndës së grafikës reklamuese në Akademinë e Arteve në Prishtinë. Realizoi disa ekspozita personale, si në Galerinë “La Nuova Pesa” në Romë (1958) dhe në Galerinë e Arteve të Kosovës në Prishtinë (1987). Që herët mori pjesë në ekspozitat kolektive të Shoqatës së Artistëve Aplikativë të Kosovës dhe të Shoqatës së Artistëve të Arteve të Aplikuara të Serbisë, të organizuara në galeri prestigjioze të ish-Jugosllavisë dhe në botë. Është autor i shumë dizajneve grafike, siç janë ato të verërave dhe pijeve alkoolike të Kosovës, i shumë emblemave, pullave postare etj. Është ndër autorët e njohur të ish-Jugosllavisë për tapiceri, i shpërblyer disa herë. Tapiceritë e tij gjenden në galeri, muze e institucione të ndryshme. Karakteristika e këtyre veprave është frymëzimi nga arti popullor i Kosovës. Jeton dhe vepron në Beograd. (Blerim Luzha)

RODOPËT. Familje bujare mesjetare e njohur në Drenicë, Trepçë dhe në disa vende të tjera në Kosovë. Familja kishte prona në rajonin e

sunduar nga Brankoviçët dhe ishte aktive në tregtinë e mineraleve në Trepçë. Në burimet dokumentare, Rodopët për herë të parë dalin në vitin 1402, kur një prej anëtarëve të kësaj familjeje kontribuoi në lirim të despotit Gjurgj Brankoviçit nga burgu i Konstandinopojës, i cili ishte burgosur gjatë Betejës së Angorës (1402). Në testamentin e një tregtari raguzan nga viti 1430, i cili i lë motrës së saj në Trepçë një sasi argjendi, përmendet Nikollë Rodopi. Një Rodop (*lo fradel de Rodop*) përmendet më 1431, i cili, gjatë luftës së Konavles, del si i dërguar i Sandal Hranicit. Ndërkaq, më 1435, Nikollë Rodopi, si protovestiar, ishte dëshmitar me rastin e një marrëveshjeje ndërmjet Gjurgj Brankoviçit dhe Republikës së Venedikut. Pas vdekjes së Nikollës (1436), ai la pas të bijtë Gjonin dhe Shtjefnin. Gjoni dhe Shtjefën Rodopi në vitin 1441 u dëbuan nga osmanët dhe shkuan në Raguzë.

Në rajonin e Drenicës, në rrënojat e Kishës së Shën Nikollës, në fshatin Banjë gjendet një gur varri me emrin e Rodopit, si donator i kësaj kishe. Gjatë gërmimeve është gjetur një pllakë varri me mbishkrim, ku emri i Nikollë Rodopit është regjistruar si dhurues i dy kabanave prej bronzi në vitin 1432: njërin për Kishën e Shën Mërisë në Hvosne dhe të dytën për Kishën e Shën Nikollës në fshatin Banjë të Skënderajt, ku edhe ishte varrosur. (Gjon Berisha)

ROGOÇICA. Fshat në komunën e Kamenicës, rreth 13 km në lindje të qendrës komunale. Shtrihet rrëzë kodrës Brija, në anën e majtë të lumit Reka e Madhe (lumi i Hogoshtit), në lartësi mbidetare 460 m. Gjetjet arkeologjike në territorin e fshatit dëshmojnë për lashtësinë e këtij vendbanimi. Përmendet në disa dokumente të shkruara. Në regjistrin kadastral osman (1455) të vilajetit Vëllk përmendet me emrin Rogoçicë, me gjithsej 3 shtëpi. Në vitet '20 të shekullit të kaluar, këtu vendosen 21 familje kolonësh serbë. Prej vitit 1944 deri në vitin 1958 ishte komunë. Në vitin 1948 kishte 1,111 banorë, ndërsa në vitin 2011 kishte 2,668 banorë. Veprimtari kryesore ekonomike është bujqësia. Është qendër e disa vendbanimeve: Hodonoc, Muçivërcë, Dajkoc, Shipashnicë e Epërme dhe e Poshtme, Karaçevë e Epërme dhe e Poshtme, e disa vendbanimeve të rrethinës së Hogoshtit dhe të një pjese të komunës së Bujanocit. Nga objektet e standardit shoqëror ka shkollën 9-vjeçare, dy shkolla të mesme, qendrën shëndetësore të mjekësisë

familjare, postën, klubin e atletikës "Rogana" (6 herë kampion i Republikës së Kosovës), disa njësi tregtare, hoteliere e zeytare etj. (Muhamed Kallaba).

ROGOVA Hasan Pashë (?-1603). Sadriazem i Perandorisë Osmane me origjinë shqiptare. Lindi në Rogovë të Hasit, në çerekun e dytë të shek. XVI. Në moshë të re u mor devshirm dhe pas edukimit dhe aftësimit, hyri në strukturat ushtarake të Portës së Lartë. Ushtri detyra të rëndësishme në pallatin sulltanor. Në vitin 1596 iu dha grada e vezirit dhe u emërua përgjegjës për çështje të furnizimeve në Beograd. Pastaj u gradua ministër dhe zëvendëskryeministër, ndërsa më 1601 u emërua nga sulltani kryeministër (sadriazem). Në këtë kohë u martua me princeshën Ajshe, të bijën e sulltan Mehmedit III. Në pozitën e kryeministrit qëndroi deri në vitin 1603, kur u ekzekutua nga sulltani. Gëzonte përkrahjen e Koxha Sinan Pashës dhe mbante lidhje me familjarët e tij edhe pas vdekjes së Sinan Pashës. Hasan Pasha në vendlindjen e tij ka ngritur një kompleks urban, i cili përbëhej nga ujësjellësi, hamami, kulla dhe xhamia, të cilat i ndërtoi para vitit 1580. Në vitin 1589 ndërtoi një urë mbi lumin Drin. Me këtë kompleks urban, Rogova që nga viti 1580 e fitoi statusin e kasabasë. Nga këto objekte është ruajtur vetëm xhamia dhe kulla. Mbishkrimin e kësaj xhamie dhe atë të urës i ka përpiluar poeti i famshëm i kohës, Ahmed "Valih" Shkupi. Kulla e Hasan Pashës është kulla më e vjetër e ruajtur në Kosovë. (Nehat Krasniqi)

ROGOVA. Fshat në komunën e Gjakovës, rreth 16 km në juglindje të saj. Shtrihet në bregun e djathtë të lumit Drini i Bardhë, në lartësi mbidetare 320 m dhe i takon krahinës së Hasit. Është vendbanim fushor i tipit të grumbulluar. Është njëri ndër vendbanimet më të vjetra jo vetëm në Kosovë, por edhe në tërë Ballkanin. Në Rogovë është zbuluar një varrezë e kohës së bronzit, rreth 1,300 vjet para erës së re. Ndër objektet më të vjetra në Rogovë është Kulla e Pogës dhe Kamza e Urës, që ka qenë pjesë e urës së vjetër e ndërtuar mbi lumin Drini i Bardhë. Xhamia, e ndërtuar në vitin 1575, është ndër objektet më të vjetra të kultit, e vendosur në qendër të fshatit. Popullsia merret kryesisht me bujqësi, perimtari dhe blegtori. Një numër i konsiderueshëm i banorëve punon dhe jeton jashtë Kosovës. Në vitin 2011 Rogova kishte

4,115 banorë, ndaj 557 banorëve në vitin 1921. Është qendër lokale e disa lagjeve përreth. Ka shkollë 9-vjeçare, shkollë të mesme, qendër shëndetësore, disa objekte zejtare dhe tregtare, tregun lokal etj. (Qerim Kastrati)

ROGOVA-GAXHA Blerina (1982-). Poete. Lindi në Gjakovë. Kreu shkollimin fillor dhe të mesëm në vendlindje, studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës. Po në këtë degë vazhdoi studimet master dhe të doktoratës. Ka punuar si mësimdhënëse e letërsisë në shkollë të mesme, gazetares në programin shqip të BBC-së dhe redaktore e kulturës në gazetën e përditshme “Zëri”. Së fundi është zgjedhur asistente në Universitetin e Gjakovës dhe punon si kolumniste në mediumin “BIRN - Jeta në Kosovë”. Ka botuar këta libra poetikë: “Gorgonë” (2009), “Kate” (2013) dhe “Ajo vjen nga lindja” (2016). Shkruan edhe ese. Poezitë dhe esetë e saj janë përkthyer në disa gjuhë dhe janë botuar në revista të ndryshme letrare. Është fituese e një sërë çmimesh letrare, përfshirë edhe çmimin e Mitingut të Poezisë në Gjakovë të vitit 2010 për librin më të mirë të poezive. Është pjesëmarrëse në disa festivale ndërkombëtare të letërsisë. (Adil Olluri)

ROGOVALI Bajram Ibrahim (1947-). Shkrimtar i letërsisë turke në Kosovë. Lindi në Prizren. Është publicist që përfaqëson gjeneratën e dytë të komunitetit turk në Kosovë. Është autor i një sërë veprash me poezi të botuara në Kosovë, Maqedoni dhe Turqi. Temat e poezive janë të ndërlidhura me dashurinë, kujtimet e kaluara, përshkrimet e bukurisë së natyrës e ndonjëherë preokupohet edhe me tema sociale. “Ura e paqes” është një panoramë e poezive të autorit, të cilat janë përkthyer për herë të parë në gjuhën shqipe. Autori është fitues i disa çmimeve për poezi. Poezitë e tij janë pjesë e disa antologjive brenda Republikës së Kosovës dhe jashtë saj. (Irfan Morina)

ROGOZNA. Mal në veriperëndim të Kosovës, i krijuar me rrudhosjet e terciarit të vonë. Shtrihet në një hapësirë të gjerë, pjesë të të cilit arrijnë deri te lugina e Ibrit dhe qyteti i Mitrovicës. Rogoznën, në formë gjysmëharku, nga jugu dhe lindja e kufizon lugina e epërme e Ibrit dhe ultësira e Mitrovicës, përkatësisht, lugina e poshtme e Ibrit. Nga veriu shtrihet

deri te lugina e lumit Banja e Mitrovicës. Rogozna ka shtrirje në katër komuna të Kosovës: Mitrovicë, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan. Nga ana perëndimore malet e Rogoznës paraqesin kufirin shtetëror të Kosovës me Serbinë. Peizazhin natyror të saj e karakterizon një morfologji e ashpër. Janë male me lartësi mesatare nga 800 deri 1,200 m (maja më e lartë - Maja e Zezë, 1,504 m), të përshkuara me lugina të thella e të ngushta, me shpate të rrëpirëta të mbuluara me kullota, livadhe e formacione pyjore. Majat më të larta, që shtrihen në zonën kufitare me Serbinë, kanë rënie graduale në drejtim të jugut dhe të lindjes deri te lugina e Ibrit në formë të grykave me shpate të rrëpirëta. Pjesën më të madhe e përbëjnë shkëmbinjtë vullkanikë, rreshet kristalore, gëlqerorët etj. Është i mbuluar nga dushku deri në lartësi 600-900 m. Aktiviteti intensiv vullkanik në të kaluarën ka kushtëzuar edhe pasuritë e mineraleve të plumbit, zinkut, argjendit, bakrit dhe arit. (Bektesh Vidishiqi)


ROHAN Albert (Prince Albert de Rohan) (1936-). Diplomati austriak, pinjoll i familjes fisnike Rohan, të arratisur pas Revolucionit Francez nga Franca në Austri, bartës i një num-



ALBER ROHAN

ri postesh diplomatike në shërbimin e jashtëm austriak, përfshirë edhe të ambasadorit në Argjentinë, Uruguaj e Paraguaj, pastaj funksionar i lartë në Ministrinë e Jashtme të Austrisë. Ishte zëvendës i Përfaqësuesit të Posaçëm të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, Marti Ahtisarit, në negociatat për zgjidhjen e statusit të Kosovës, të njohura si “Negociatat e Vjenës”. (Ilir Dugolli)

ROK Mario (Roques) (1875-1961). Gjuhëtar, filolog frëng. Përfundoi studimet në Ecole Normale Supérieure në Francë. Ishte anëtar i Akademisë së Shkencave të Francës. Ndër interesimet e tij bënte pjesë edhe shqipja. Mbahti mësimet të shqipes në INALCO (Instituti Kombëtar i Gjuhëve dhe i Civilizimeve Orientale) në Paris. Dha kontribut në fushën e studimit dhe të botimit të teksteve të vjetra të shqipes. Botoi: “Fjalor shqip i vitit 1635” (Le dictionnaire albanais de 1635, botuar më 1932) që përfshin



MARIO ROK

studimin e fjalorit të Frang Bardhit dhe veprën “Kërkime mbi tekstet e vjetra shqipe” (Recherches sur les anciens textes albanais, 1932). U mor edhe me tekstet e vjetra të frëngjishtes, kryesisht duke trajtuar leksikon. (Kadire Binaj)

ROMANI. Zhanri i romanit në letërsinë e Kosovës nis me autorin Hivzi Sulejmani, i cili në vitin 1951 shkroi romanin “Njerëzit”, ku shkrihet diskursi social, ideologjik e utopik për barazinë e popujve. Mbas tij, me temën e luftës dhe të ideologjisë kemi romanet “Rrushika nisë me u pjekë” (1957) të Sinan Hasanit dhe “Besniku” (1959) të Rexhai Surroit. Tema e utopisë nuk do t’i lëshojë këta dy autorë edhe në romanet e mëvonshme. Ndërkaq, si ikje nga diskursi ideologjik dhe si sforcim i metonimisë popullore kemi romanet neoiluministe me intencë të renë progresiste si “Gjarpijt e gjakut” (1958) të Adem Demaçit, pastaj “Karvani i bardhë” (1961) i Azem Shkrelit dhe “Malsorja” (1965) e Nazmi Rrahmanit. Mirëpo, konsolidimi strukturor, narrativ e tematik i romanit të Kosovës arrihet sidomos në vitet ‘70 me autorët: Anton Pashku, Rexhep Qosja, Zejnullah Rrahmani, Ramiz Kelmendi, Teki Dërvishi, Sabri Hamiti, Jusuf Buxhovi, Musa Ramadani, Beqir Musliu, Mehmet Kraja etj., ku hetohet shumëzëshmëria e kësaj forme letrare. Anton Pashku me romanin “Oh” (1971) thyen poetikën e mëparshme narrative për të krijuar prozën romanësore të stilit të lartë, meditacionit dhe të lojës së simbolikave në rrafsh personal, arkinacional e antiideologjik të kundruara në sinkretizim kohor historik e modern. Rexhep Qosja hap tregime-romanin “Vdekja më vjen prej syve të tillë” (1974) si mozaik të trajtave të përpjekjes së intelektualit për t’i mbijetuar aparaturës orveliane, temë që do ta trajtojë më vonë Ramiz Kelmendi te romani “Shtatë persona ndjekin autorin” (1975). Kurse Zejnullah Rrahmani trajton temën nacionale te romanet “Zanoret e humbura” (1974) dhe “Sheshi i unazës” (1978), temë që do ta përcjellë këtë autor edhe në romanet e mëvonshme. Sabri Hamiti, duke parë shkrimin si krijim të një bote specifike, shkruan romanin “Njëqind vjet vetmi” (1976) si sagë të vetmisë familjare të shtrirë në projektionin

shekullor të vetmisë nacionale. Ndërkaq, Jusuf Buxhovi do të nisë romanet e alegorizimit dhe risemantizimit historik me veprën “Matanëkre-na” (1976), temë që do ta vijojë edhe në romanet e mëvonshme, ku nga më të shquarit mbetet “Shënimet e Gjon Nikollë Kazazit” (1982). Teki Dërvishi, Beqir Musliu e Musa Ramadani do të trajtojnë tema të ndryshme: alegorinë e burgimit, traditën e mistikën si dhe eksperimentimin narrativ te romanet: Dërvishi te “Padrona” (1974), Ramadani te “Romani pa kornizë” (1975) e Musliu te “Vegullia” (1979), tematikë që do t’i përcjellë edhe në veprat e mëvonshme. Mehmet Kraja i ngjitet brezit me romanin për njeriun e kohës së tij “Gjurmë në trotuar” (1977) për ta ndryshuar fahun me romanet e imagjinariteteve historike, të cilat vijnë në vitet 80’ me titujt “Portali i perëndive të fyera” (1980) e “Moti i Madh” (1981). Autorët themelorë të prozës romanësore Zejnullah Rrahmani, Beqir Musliu, Musa Ramadani, Teki Dërvishi, Jusuf Buxhovi, Mehmet Kraja do të vijojnë shkrimin e këtij zhanri edhe në vitet ‘80 e ‘90, secili sipas temave dhe stileve individuale, të provuara në prozat e tyre të mëparshme. Janë këta autorët që konsoliduan këtë zhanër për të mbetur ikona të kësaj forme deri më sot. Zejnullah Rrahmani do të botojë romanet e dhembjes etnike, me stil e kompozicion modern si “Udhëtimi arbdhetar” (1992), “Jusufi” (1999) e “Romani për Kosovën” (1999). Beqir Musliu do të shkruajë në variante alegorinë e mistikën romanësore “Mbledhësit e purpurit” (1982), ndërsa Musa Ramadani do të botojë romanet e fatumit të njeriut të Kosovës, “Zezona” (1978) e “Ligatina” (1983). Teki Dërvishi vijon alegorinë e burgimit dhe ironinë romanësore te “Herezia e Dërvish Mallutës” (1981), ndërsa Jusuf Buxhovi vijon trilogjitë romanësore “Prapë vdekja” (1991-1995) të kthimit të historisë etnike e nacionale në fakt letrar. Mehmet Kraja hulumton në mesjetën shqiptare me romanin “Net bizantine” (1994) për të vazhduar me romanet që kanë për topos hapësirën nacionale. Ndërkaq, në vitet ‘90 nisin krijimtarinë dy romancierë, Migjen Kelmendi me veprën “Gryka e kohës” (1994) dhe Kujtim Rrahmani me “Secili e citonte Biblën” (1994) të cilët, nën ndikimin e autorëve Borhes, Kafka e Kish, madje edhe nga poetikat e reja të thyerjes së rrëfimeve të mëdha, shkruajnë sipas poetikës së amalgamit të faksionit me fiksionin. Kriza e Kosovës e viteve ‘90-‘99 dhe pasoja e saj ndikoi në ndryshimin e perceptimit karshi veprave e

fenomeneve letrare. Romani vijoi të shkruhej nga autorët klasikë të letërsisë së Kosovës, siç janë Rexhep Qosja me romanin “Një dashuri dhe shtatë faje” (2001) si vijimësi e prozës për fatin e intelektualit shqiptar në kohë të thyerjeve ideologjike, Teki Dërvishi me romanin “Palimpsest Dush Kusarit” (1993), si rikujtesë e burgimeve shqiptare, Musa Ramadani me veprat “Antiprocioni” (1997) dhe “Inamor: 55” (2000) si lojë formash e temash letrare, Zejnullah Rahmani me veprat “Jusufi” (2000), “99 rruzaret prej smaragdi” (2006) si vijimësi e trajtimit të krizave etnike-nacionale, Mehmet Kraja me veprën “Im atë donte Adolfin” (2005), reminishenca nga vendlindja si perceptcion historik etj. E veçantë në prozën e saj del edhe Hida Halimi me romanet “Ai që nuk ishte Fidia” (1995) dhe “Njeriu im” (1997) si gamë e gjerë e simbolikave jetësore e imagjinare të shndërruara në evidenca letrare. Kjo traditë e romanit shqiptar në Kosovë vijon të përplotësohet me tendencën e shkrimit të romanit postmodern me shkrimtarët Ardian Haxhaj, Ag Apolloni, Gëzim Aliu, Agron Y. Gashi etj. Në këtë plejadë duhet të përmendim autorin Rexhep M. Shala, i cili, ndonjëse studiues i letërsisë për dekada me radhë, boton prozën fikzionale më vonë dhe shquhet me veçantinë e shkrimit romanësor te veprat “Papa Global World” (2002), “Opium” (2009) e “Fama” (2012), të cilat hapin shkrimin drejt honeve metafizike. Sidoqoftë, romani ynë kontinuitetin e vet ende e mban me autorët e formuar në vitet 70’ të shekullit të kaluar. (Nysret Krasniqi)

ROMANIZMAT. Huazime nga ndonjë gjuhë romane në ndonjë gjuhë tjetër, konkretisht në shqipen, në cilëndo fazë të zhvillimit. Aty hyjnë edhe huazimet nga latinishtja popullore dhe nga gjuhët neolatine si dalmatishtja e zhdukur, italishtja, frëngjishtja, spanjishtja, rumanishtja bashkë me arumanishten. Bëhet dallimi midis latinizmave që kanë hyrë në faza të hershme të shqipes (ilirishtes) nga fillimet e pushtimit të Ilirisë në sh. II të Epokës së Vjetër për të vazhduar edhe në faza të mëvona. Fakti se latinizmat e shqipes kanë hyrë nga gjuha popullore, pra nga “gjuha romake”, ka bërë që për romanizma të flitet edhe për faza kur ende nuk ishin formuar gjuhët e veçanta romane. Procesi që kanë pësuar hapësirat ballkanike pas pushtimeve të Romës njihet si romanizim dhe si pasojë e tij ka qenë asimilimi gjuhësor në shkallë të ndryshme. Latinishtja ka qenë

gjuha e Perandorisë deri në ndarjen e saj më 395 pas Krishtit, por ka vazhduar të jetë gjuhë zyrtare edhe në Perandorinë e Lindjes deri në sh. VII. Ky proces ka qenë gradual dhe në disa vise ka arritur të jetë i plotë deri në kohën e ardhjes së sllavëve në Ballkan. Bregdeti dalmat, Dacia qenë hapësira ku romanizimi ka qenë i plotë. Kësaj vale të madhe të romanizimit, pos greqishtes që ishte bartëse e kulturës së shkruar, i ka shpëtuar dhe gjuha shqipe, e cila po ashtu ka pësuar ndikime të mëdha nga këto procese që kanë zgjatur me shekuj. Ato pak përdorime të gjuhëve të lashta që do të kenë mbijetuar deri në kohën e depërtimeve sllave në shumë vise të Ballkanit janë zhdukur përfundimisht përmes sllavizimit intensiv. Latinizmat e shqipes janë nga gjuha popullore, nga e cila u zhvilluan dhe gjuhët romane. Mendohet se për gjuhë të veçanta romane duhet të flitet pas sh. VII-VIII, sado që një kufi i prerë është vështirë të vihet. Nga latinishtja popullore në Ballkan janë zhvilluar dalmatishtja dhe rumanishtja. Gjurmët e ndikimit latin në shqipen janë të gjera dhe kjo flet për një bashkëjetesë të tyre për një kohë të gjatë. Në shqipen njihet një shtresë e latinizmave që paraqesin një gjendje më të vjetër se secila prej gjuhëve romane. Kemi fjalë si *qepë, qiqër, ar, gaz, pemë, herë, mjek, kut, rreze, zanë*; fjalë latine që janë ruajtur në shqipen: *bujk, tërfurk*, ose që nuk ndeshen në rumanishten: *mik, bekoj, kështjellë, qind, gjel, mulli, rjetë, vullnet*, etj. Terminologjia kishtare e krishterë e hershme në shqipen është e burimit latin dhe jo grek apo sllav: *kishë, lter, prift, mëkat, pagëztoj, shëlboj, shpirt*. Shembuj nga sfera të ndryshme: *ungj, emtë, krushk, kushëri, mashkull, prind; mjek, mjeshtër, qytet, shoq; faqe, flok, fytyrë, këmbë, kofshë, kokë, mendje, shpatull, shpinë, shtat; kafshë, lepur, pulë, qen; furrë, mur, kulm, pëllas, qepër, tjegull; farkë, furkë, kaproll, musht, myshk, parmendë, pjeshkë, qerre, tërshërë, vaj, mritz; gusht, janar, fror, mars, prill, verë; këngë, kuvend, pashkë, kryq; bekoj, duroj, lëvdoj, mërzej, shpërej, trishtoj*, etj. Ndikimi latin është shënuar edhe në prapashtesa: *-atë: dhuratë, gjykatë, kafshatë; -eshë: luaneshë, bareshë, mikeshë; -tyrë: shërbëtyrë, shembëlltyrë*; prapashtesa *stër-: stërdhëmb, stërgjysh, stërholloj, stëmundohem*. Mendohet po ashtu se prapashtesat *-ar* dhe *-tor* janë me burim latin. Huazime latine në shqipen ka pasur më vonë dhe nga gjuha libreske, sidomos në terminologji.

Huazimet e mirëfillta romane, pra huazimet nga gjuhët romane (rijolatine), të shqipes shihen më të vona se sh. X. Fjalë si *monedhë, vidë, manestër, barkë, vapor, rem, shirok, tornitor, muzikë, bas, soprano*, janë huazime nga italishtja. Po kështu nga frëngjishtja kemi huazime nga kontaktet e vona kulturore: *dosje, kod, byro, prokuror, arbitrazh, hotel, atelie, bezh, bluzë garazh, sharlatan, shovinizëm, atashe, prizë, klishe, marsh, pardesy, solfezh, triko, turn*, etj. Nga një bazë romane e kanë burimin prapashtesat e parashtesa: *ri-*: *rindërtoj*; prapashtesat *-ist*: *majtist*; *-izëm*: *iluminizëm, djathtëzim*. Nga dalmatishtja mendohet të kenë hyrë fjalë si kumbonë, koftor, ndërsa nga spanjishtja kemi fjalën pallavër, etj. Nga rumanishtja fjalë si *me trasë* në veri, apo nga arumanishtja në jug *fior, milor* etj.

Në arbërishten e Italisë, që flitet në mjedis italian mbi pesë shekuj, ka shumë më tepër italianizma (nga varietete kalabreze e siciliane dhe nga italishtja). Romanizmat e shqipes janë studiuar nga F. Mikloshiq, V. Mejer-Lybke, G. Majer, H. Pedersen, N. Jokl, P. Skok, H. Bariq, E. Çabej, H. Mihëjesku, H. Harman, J. Kristofson, G. Bonet, Sh. Demiraj, C. Vëtshesku, G. Pelegrini, A. Rosi-Landi, S. Mansaku, R. Ismajli etj. (Rexhep Ismajli)

ROMISHTJA. Gjuhë e bashkësisë së shpërndarë rome që jeton edhe në Kosovë. Nuk ka saktësi, por mendohet se një pjesë e tyre të kenë ardhur përmes Egjiptit, me çka shpjegohen emërtimet magjypë, egjiptas, evgjitë, jegjupci, djupci. Prejardhja e tyre është nga India e Veriut. Romët janë të shpërndarë nëpër Europën Juglindore dhe më tej. Njihën me emra të ndryshëm: ciganë, evgjitë, magjupë, gabelë, arixhinj, gjorgovcë etj. Emërtimi neutral është rom, kurse gjuha romishte. Në Ballkan përmenden në shek. XIV. Jetojnë kryesisht nëpër qytete. Në botë jetojnë 1 deri 2 milionë. Dallohen disa grupe: grupi në zonat e Baltikut dhe në Poloni të Jugut, Transilvani; grupi në Hungari, Rumani, Moldavi, Vojvodinë; grupi në Serbi, Kosovë, Shqipëri, Bullgari, Maqedoni dhe Greqi; grupi rus dhe ukrainas, ndërsa dialektet janë të shumta. Vetëm në Kosovë ndeshen 7 të folme të ndryshme rome. Për gjuhën e romëve në Ballkan kanë shkruar Kurtiad, Fridman, Borecki e të tjerë. Ka tentime për ta bërë gjuhë të shkruar, por ndryshimet e mëdha dialektore dhe ndikimet e gjuhëve të

tjera e vështirësojnë këtë synim. Në Kosovë gjuha rome përdoret në mjetet e komunikimit masiv televiziv. Një emision televiziv në gjuhën rome ka qenë që nga vitet '80 të shekullit të kaluar në Radiotelevizionin e Prishtinës. (Ganimet Klaiqi)

ROSI Françesko (Francesco Rossi) (1814-1888). Misionar katolik, studiues i shqipes. Lindi në Monalto Ligure, në Itali. Më 1833 u emërua prefekt i misionit françeskan për Serbinë dhe Shqipërinë. Ka rimarrë gramatikën e shqipes dhe fjalorin e Da Leçes. Më 1866 botoi "Rregullat gramatikore të gjuhës shqipe" (Regole grammaticali della lingua albanese-sulle tracce di buoni gramatici del Padre Francesco M. Da Lecce) dhe po atë vit edhe fjalorin "Fjalor italisht-epirotisht" (Vocabolario italiano-epirotico, con tavola sinottica). Fjalori i tij përmban mbi 11,000 fjalë të shqipes. (Imri Badallaj)

ROSUJA. Qytezë dardane në Tropojë (Shqipëri). Shtrihet në kodrat "Gjyteti i Madh" dhe "Gjyteti i Vogël" në veri të fshatit Rosujë. Vendbanimi është krijuar në shek. V p.e.r., por u rrethua me mure prej blloqesh gëlqerore të punuar trashë në shek. IV p.e.r., në sipërfaqe prej rreth 0.7 ha. Një shekull më vonë u rindërtua pjesa më e lartë e fortifikimit me blloqe të punuar me forma kuadratike, ndërsa vendbanimi u shtri edhe jashtë mureve. Periudhës i takojnë banesa me parete druri dhe një depo drithi me pitosa. Karakteristike është qeramika qytetare dardane me baltë ngjyrë gri, e punuar me çark, me forma lokale apo helenistike. Me këtë shtresë lidhet një monedhë argjendi e Dyrrahut e tipit lopë me viç/katror i stilizuar, një e Apolonisë e të njëjtit tip dhe një monedhë bronzi e Shkodrës. Një vulë tjegulle me emrin Morgos mund të lidhet me delegatin që mbreti Gent e dërgoi te Perseu në vitin 168 p.e.r. Periudha e fundit e jetës në Rosujë i takon shek. IV, kur qyteza u rifortifikua me mure gurësh të vegjël të lidhur me llaç. Vendosija e banesave njëkthinëshe me mure guri përgjatë muronit dëshmon se shërbeu si kështjellë garnizoni për kontrollin e rrugës që shkonte nga Dardania në Shkodër. Tipike për këtë periudhë është qeramika me dekoracion "fshese", që datohet në gjysmën e dytë të shek. IV nga monedha prej bronzi e perandorit Valentinian II. Shtresa e djegies, që

shënon përfundimin e jetës në qytezë, lidhet me sulmet gote. U gërmua në vitet 1964-1965. (Neritan Ceka)

ROZHAJA Dervish (1934-1996). Biolog, profesor universiteti, akademik. Lindi në Pejë, shkollën fillore dhe progjimnazin i kreu në vendlindje, Shkollën Normale në Gjakovë, ndërsa studimet në degën e biologjisë në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore (FSHMN) të Universitetit të Beogradit (1954). Një kohë punoi në Shkollën Normale të Prishtinës (1954-55). Disertacionin e doktoratës



DERVISH ROZHAJA

e përfundoi në Institutin Fiziologjik të FSHMN-së të Universitetit të Beogradit (1959) dhe bëhet doktori më i ri i shkencave në ish-Jugosllavi. Një vit më vonë zgjidhet docent në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës (1960), profesor inordinar (1968) dhe ordinar (1974). Kreu funksione të ndryshme në institucionet e arsimit të lartë, përfshirë edhe rektor i parë i Universitetit të Prishtinës (1970-1973), pastaj nënkryetar dhe kryetar i Akademisë së Shkencave dhe i Arteve të Kosovës (1982-1984). Ka qenë anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, pastaj kryetar i Bashkësisë së Universiteteve të ish-Jugosllavisë dhe delegat në dhomën e Kombeve të Kuvendit të ish-Jugosllavisë. Ishte mësimdhënës i lëndës fiziologjia krahasuese dhe evolucioni organik. Kreu specializime në Institutin Fiziologjik në Universitetin e Leningradit (1962-63) dhe në Institutin Neurologjik të Fakultetit të Mjekësisë në Los Angeles (1973-1974). Qëndrime shkencore bëri në Universitetin e Goteborgut dhe Lundit në Norvegji dhe në Akademinë Mbretërore të Shkencës (Royal Academy of Sciences) të Anglisë. Botoi në revista të ndryshme shkencore punime nga fusha e adaptimit termik të shtazëve poikiloterme dhe të termoregulacionit dhe hipotermisë së shtazëve homeoterme dhe heteroterme. U mor me problemet e ruajtjes së mjedisit (1970) dhe, si bashkautor, botoi tekstin universitar “Ndotja dhe mbrojtja e mjedisit” (1983) dhe “Fiziologjia krahasuese” (2000). Ishte redaktor i revistës “Acta Biologica et Medica Experimentalis”. Për kontributin e tij në lëmin e kërkimeve shkencore, të ngritjes së

kuadrit universitar, në zhvillimin institucional dhe për afirmimin e Universitetit të Prishtinës është nderuar me shumë mirënjohje dhe dekorata, përfshirë edhe dekoratën e presidentit të Francës në vitin 1977. (Feriz Krasniqi)

RUBIN Xhejms (James) (1960-). Politikan, gazetar e diplomat amerikan. Lindi në Nju-Jork. Studioi për shkencë politike dhe doktoroi në këtë fushë në Universitetin Columbia (1982). Një kohë punoi si anëtar profesional i stafit të Komitetit të Senatit për Marrëdhënie me Jashtë të SHBA-së dhe këshilltar për politikë të jashtme i senatorit Joseph R. Biden dhe më pas ishte këshilltar i lartë i Sekretares së Shtetit,



XHEJMS RUBIN

Medelin Olbrajt, në periudhën kur ajo ishte ambasadore e SHBA-ve në Kombet e Bashkuara. Gjatë fushatës presidenciale të vitit 1996 ishte përgjegjës për politikë të jashtme dhe zëdhënës i Presidentit Klinton dhe i zëvendës-presidentit Al Gor. Në vitin 1997 zgjidhet ndihmës i sekretares së Shtetit dhe shef i zyrës për informim, si dhe zëdhënës i Departamentit të Shtetit. Në këtë periudhë u bë i njohur me paraqitjet publike rreth zhvillimeve në Kosovë, gjatë Konferencës së Rambujesë dhe më pas me ndërhyrjen e forcave të NATO-s në Kosovë. Përveç karrierës shtetërore, zhvilloi edhe karrierë akademike. Gjatë vitit 2013-14 ishte studiues vizitor në Institutin Amerikan Rothermere në Universitetin e Oksfordit. Shkroi artikuj për gazetën “Sunday Times” të Londrës, pastaj ishte gazetar televiziv dhe komentator në TV “Sky News”. (Frashër Demaj)

RUDI Agim (1947). Skulptor. Lindi në Gjakovë. Kreu shkollimin fillor dhe të mesëm në vendlindje, ndërsa studimet për skulpturë në Akademinë e Arteve në Lubjanë (1977). Punoi si scenograf në Televizionin e Prishtinës. Nga viti 1993 ligjëroi lëndën e skulpturës në Fakultetin e Arteve në Prishtinë. Hapi ekspozita personale në Foajeun e Teatrit në Prishtinë (1984), pastaj në Galerinë “Kajros” (1993), sërish në Prishtinë, në Galerinë “Intermedia” (1995), në Shtëpinë e Kulturës në Mitrovicë (2002), si dhe në Çikago (2014) dhe në Grand Rapids në SHBA (2015). Mori pjesë në një sërë



AGIM RUDI

ekspozitash të përbashkëta: në Lubjanë (1974, 1975, 1976), pastaj në të gjitha ekspozitat e Shoqatës së Artistëve Figurativë të Kosovës (SHAFK), në Bienalen VI të plastikës së vogël në Murska Sobota, Lubjanë dhe Maribor të Sllovenisë, në

Bienalet e Vizatimit në Prishtinë, në Grozhnjan të Kroacisë, në ekspozitat e SHAFK-ut në Beograd, Nish dhe Novi-Sad, në Bienalen e Cetinës, në ekspozitën tematike “Golgota Kosovare” në Galerinë e Arteve në Prishtinë, si dhe në Neshvill, Bruksel, Grand Rapids (SHBA) etj. Mori çmimin vjetor të SHAFK-ut më 1980, pastaj çmimin e parë nga FSC “Social Price” në SHBA (2013) etj. Gjithashtu realizoi disa monumente të vendosura në vende publike në Kosovë. Më 1990 realizoi shtatoren e “Nënë Terezës” në Kishën Katolike në Novosellë të Gjakovës. Krijimtaria e tij artistike karakterizohet për nga fryma e artit ekspresiv, me primesa abstrakte të motiveve autoktone kosovare. (Luan Mulliqi)

RUDI Donika (1982-). Kompozitore. E para ndër ne e specializuar për muzikë elektroakustike, akusmatike. Studioi kompozimin në Konservatorin e Muzikës në Gjenevë, drejtimet: muzikë instrumentale (prof. É. Gaudibert, M. Jarrell) dhe elektroakustike (prof. R. Boesch, L. Naón). Studimet master të kompozimit, Seksioni elektroakustik e akusmatik i kreu në Konservatorin Mbretëror në Mons, Belgjikë (prof. A. Vande Gorne, I. Drese). Disa nga veprat e saj të rëndësishme janë: Baleti “Life in Slow Motion” (u dha premierë në Teatrin Kombëtar në Prishtinë), “9” për trombon të amplifikuar e shirit manjetik, “Aura I” për violinë, violë, mezosoprano, soprano, perkusion shirit manjetik, “Emotion Machine” vepër akusmatike, “Within” (Emotion Machine II) dhe “Voyage vers l’inconnu”. Ka kompozuar për teatër, film dokumentar dhe është autore e librave për fëmijë. Veprat e saj janë ekzekutuar në Portugali, Kolumbi, Itali, Kosovë, Shqipëri, Francë, Belgjikë, Zvicër, Spanjë, Kanada, janë dhënë në Radio Spain-UNDAE, France Musique, Dutch National Radio, “SonemaLab”, Portugese National Radio. Nga viti 2010 është anëtare e Shoqatës së Kompozitorëve Belgë të Muzikës Elektroakustike EBEME-BEFEM, anëtare e

“Canadian Electroacoustic Community”. Është drejtoresh e Festivalit Ndërkombëtar “Re-Musica” në Prishtinë. (Nestor Kraja)

RUDI Drita (1957-). Pedagoge e muzikës, drejtuese e korit të fëmijëve. Lindi në Ferizaj. Shkollën e Mesme të Muzikës dhe Fakultetin e Arteve, drejtimi i pedagogjisë muzikore, i kreu në Prishtinë. Punoi në korin profesionist të Radiotelevizionit të Prishtinës, ishte mësime-dhënëse në disa shkolla fillore të Prishtinës dhe në Shkollën e Ulët të Muzikës në Pejë. Punoi në drejtorinë për kulturë në administratën komunale të Prishtinës. Ishte inspektore dhe këshilltare e arsimit për lëndën e muzikës. Më 1992/93 themeloi korin e fëmijëve “Xixëllonjat” dhe realizoi mbi 1,500 koncerte brenda e jashtë vendit, si në Gjermani, Zvicër e Suedi. Mori pjesë në festivalet “Eurofest”, ku u shpërblye me “Grand Prix”, në “Noelbaba” (Turqi) në “Fjolla e artë” dhe “Rrugët e arta” në Rozhajë, në “Showfest”, pastaj në Milano me Coro d’Italia. Si kompozitore e këngës për fëmijë mori pjesë në “Akordet e Kosovës”, “Festivali i fëmijëve” “Kënga e pranverës”, “Ylberi”, “Bletëzat”. Është themeluese e festivalit “Prishtina Kids Fest” (2009) dhe autore e bashkautore e librave shkollorë “Edukata muzikore”, klasat I-VI, e albumit të këngëve për fëmijë “Xixëllonjat” dhe e CD-së për edukimin parashkollor. (Indira Çipa)

RUDI Hysni (1917-1947). Ushtarak, pjesëmarrës në lëvizjen antifashiste dhe në Lëvizjen Nacional-Demokratike Shqiptare (LNDSH). Lindi në Mitrovicë. Kreu Kolegjin Ushtarak në Romë, Akademinë Ushtarake në Torino dhe Shkollën e Lartë Ushtarake të Inxhinierisë në Romë (1942). Në vitin 1942 u caktua komandant batalioni i Ushtrisë Shqiptare në Pejë, ku bashkëpunoi edhe me Lëvizjen Nacionalçlirimtare. Si epror ushtarak, me repartin e artilerisë, luftoi me forcat vullnetare për mbrojtjen e kufijve nga forcat çetnike dhe partizane. U arrestua dhe u internua nga gjermanët si antifashist në Kampin e Prishtinës (qershor-shtator 1944). Pas liritimit nga kampi, iu bashkohet forcave partizane dhe caktohet komandant i Komandës së Vendit në Istog, pastaj komandant i Divizionit të Artilerisë në Prishtinë dhe instruktor në Brigadën V dhe VI të Shqipërisë. I zhgënjyer me aneksimin e Kosovës nga Serbia, përkatësisht Jugosllavia dhe me dhunën

dhe terrorin që po ushtrohej ndaj popullsisë, u demobilizua vullnetarisht (1946). Më pas u bashkua Lëvizjes Nacional-Demokratike. Në organizatën e LNDSh-së të Shkupit zgjidhet anëtar i Komitetit Qendror dhe komandant i Ushtrisë Demokratike Shqiptare. U arrestua nga organet e Sigurimit Jugosllav, u dënua me vdekje dhe u pushkatua në Shkup. (Muhamet Shatri).

RUDI Rafet (1949-). Kompozitor dhe dirigjent. Lindi në Mitrovicë. Kreu Shkollën e Mesme të Muzikës në Prishtinë. Kreu studimet për dirigjim më 1973 dhe më 1974 për kompozim në Akademinë e Muzikës në Beograd.



RAFET RUDI

U specializua në Paris (prof. C. Ballif, 1979-80), ndërsa u magjistrua në Sarajevë (prof. V. Kamadina). Më 1976 u zgjodh ligjërues në degën e muzikës të Fakultetit të Arteve të Universitetit të Prishtinës. Në vitet 1980-1987 ishte dirigjent i Korit profesional të Radiotelevizionit të Prishtinës. Me të u shfaq me sukses në koncerte e festivale brenda e jashtë vendit, ndërsa aktualisht është drejtues i Korit të Filarmonisë së Kosovës. Krijimtaria e tij përfshin forma dhe gjini të ndryshme muzikore, nga të cilat veçojmë veprat korale: “Lagjja e varfun” (1968), “Ishin dy kunata” (1982), “Lule gjaku, Agnus dei” (2007), “O zemra ime ku vate” (+ solist), për kor të përzier; si dhe “Lule e pavyshkur”, për kor e orkestër (1988); pastaj këngët solo: “Kthimi”, për mezosoprano e piano (1993); “Arbëresh song”, për soprano e piano (2011); veprat vokale-instrumentale: “Canti tradicional liturgici”, për 3 solistë, kor të përzier, 2 flauta, organo e timpan (1993); “Flijimi”, për solistë, kor të përzier, 3 kavallë, kontrabas, tupan, tam-tam (1993); “Afresk arbëresh III”, për solistë, oktet vokal, organo, piano 4-duarshe, shiritë magnetik (1992); “Laudate Dominum”, për solistë, kor të përzier, 2 piano e perkusione (1993); “Fantasia Concertante”, violinë, kor mikst (2012). Është autor edhe i këtyre veprave solistike e kamerale: Suitë për piano (1969), Variacione për klarinet, violinë e piano (1971), Kuartet harqesh (1972), “Meditime” për flaut e piano (1977), “Rrojta”, kitarë e kuartet harqesh (1978), Fantasia in Si për vio-

linë e piano (1985), “Këmbanat arbëreshe” për piano (1993), “Chansons et danses”, për kitarë (1998), “Prishtina blues”, për piano (2001), “Reve Nostalgique”, vepër elektronike (2003), Kuinteti “Antigoneon”, për flaut, klarinet e fagot (2005); Kuartet për flaut, klarinet në B dhe në Es (2010). Veprat orkestrale: Simfonia (1974); Kohë koncertante, piano e orkestër (1975); Rondo simfonike (1977); “Metamorphoza”, flaut, piano e orkestër harqesh (1979); Largo për orkestër harqesh (1978); Concerto, për kitarë e orkestër harqesh (1986); “Afresk arbëresh” IV, për soprano e harkorë (2004); “The Return”, për mezosoprano e orkestër (2009); Dialog Concertant për flaut e orkestër (2010). Kompozoi dhe muzikë për film. Ishte aktiv me shkrime në gazeta e revista. Ka botuar librin e eseve “Sprova estetike” (2002). (Rreze Kryeziu-Breznica)

RUFAINJTË. Themeluesi i rufaizmit ishte Ahmed er-Rifaiu (1118-1182), që rridhte nga familja e pejgamberit Muhamed. Burimet e prezantojnë si dijetar me mbi njëzet vepra të shkruara. Rufaizmi u paraqit në Irak dhe më vonë u përhap në shumë vise të botës. Pati përhapje të gjerë edhe në viset shqiptare. Në shekullin XIX dervishët e tarikatit rufai ishin më të përhapur në Kosovë dhe Maqedoni, shumë më pak në Shqipëri. Dega Sajadie, e themeluar nga nipi i Ahmed er-Rifaiut, Izedin Ahmed es-Sajad, luajti rol të rëndësishëm në jetën shoqërore dhe fetare të Kosovës. Haxhi sheh Musa Muslihuiddin Bellanica është shehu i parë i rufainjve në Kosovë. Teqeja e rufainjve të Gjakovës luajti rol të rëndësishëm në jetën shoqërore dhe kulturore në qytet dhe më gjerë. Teqenë e dytë të rufainjve në Kosovë e ndërtoi ndjekësi i sheh Musës, sheh Xhemali në Rahovec. Nga fundi i shekullit XIX u ndërtua dhe vepronte edhe një teqe e rufainjve në Prizren, e themeluar nga sheh Hasan Hysni Rifaiu. Traditën e rufainjve në Prizren e vazhdoi familja e sheh Xhemalit. Teqe të këtij secti pati edhe në Mitrovicë, Pejë dhe Gjilan, si dhe në disa qytete në Shqipëri dhe në Maqedoni. (Metin Izeti)

RUFATI Xhelil (1957-). Skulptor. Lindi në Zhuzhnjë të Rekës së Epërme në Maqedoni. Kreu studimet për skulpturë në Fakultetin e Arteve në Prishtinë. Fillimisht punoi si mësimdhënës i shkollës së mesme në Gostivar,

më vonë si pedagog në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Tetovës. Ka hapur disa ekspozita personale: në Qendrën Wus-Austria në Prishtinë (2001), në Cite des Arts në Paris (2009), në Galery MC në Nju-Jork (2013); në Galerinë Nacionale “Çifte Hamam” në Shkup (2015), në Galerinë Mytoro në Hamburg (2015), në Galerinë Nacionale “Stacioni i vogël” në Shkup (2016) etj. Është pjesëmarrës në disa ekspozita të Shoqatës së Artistëve Figurativë të Maqedonisë dhe asaj të Tetovës, të organizuara në Shkup, Tiranë, Prishtinë, Prizren, Kumanovë etj. Krijimtaria e tij karakterizohet me përdorimin e elementeve të metalit dhe materialeve të tjera, të trajtuara në mënyrë bashkëkohore. Ka realizuar dhe disa buste e skulptura të personaliteteve të rëndësishme. Jeton dhe krijon në Gostivar. (Jelldëze Asani).

RUGOVA. Trevë etnogeografike e Kosovës, me histori dhe me kulturë të veçantë autoktone. Shtrihet në Bjeshkët e Nemuna, përgjatë rrjedhjes së sipërme të lumit Bistrica. Shquhet si



PEIZAZH NGA RUGOVA

territor specifik blegtoral-agrar, me 13 fshatra. Ka strukturë të larmishme fiziko-geografike: relief të përthyer, shpella karstike, liqene glaciale, gryka erozive etj. Dallohet veçanërisht gryka e Rugovës, si atraksion i veçantë natyror-turistik. Pasuria kryesore e popullatës me shekuj ishin livadhet e kullotat, bagëtia dhe pyjet. Sipërfaqet e punueshme (arat) ishin të kufizuara, të pamjaftueshme dhe jopjellore në

të cilat mbillej elbi, thekra, patatja, ndërsa në disa fshatra me lartësi më të ulët mbidetarë edhe misri dhe lakra, me të cilat nuk plotësoheshin kërkesat ekzistenciale. Deri në vitin 1971 kishte një trend të rritjes së popullsisë (rreth 3,500 banorë), ndërsa pas këtij viti shënohet rënie, ndërsa sot kjo trevë nuk ka më shumë se 2,000 banorë rezidentë. Me shekuj ishte e izoluar në pikëpamje të komunikimit gjeografik dhe social, pa rrugë, shkolla, ambulanca, institucione kulturore e shërbyese. Elektrifikimi i fshatrave të Rugovës përfundoi në vitin 1983.

Ekonomia agraro-blegtorale, e bazuar në mënyrën e shfrytëzimit ekstensiv të të mirave natyrore, nuk ofronte mjete të mjaftueshme për jetë. Për këtë arsye emigrimi i popullsisë nga kjo trevë ka filluar që nga koha e sundimit otoman, për të marrë dimensione të gjera pas pushtimi serb të Kosovës në vitin 1912, kur pushteti vendosi tatime të rënda në livadhe dhe kullosa. Procesi i shpërnguljes vazhdoi midis dy luftërave dhe mori përmasa edhe më të mëdha pas Luftës së Dytë Botërore. Rugovasit u ngulitën në vendbanimet e Rrafshit të Dukagjinit, kryesisht në Pejë dhe në fshatrat përreth këtij qyteti. Si pasojë e këtij emigrimi ndodhi shpopullimi dhe shuarja e jetës në disa fshatra të Rugovës. Shpërngulja vazhdon edhe sot, ndonëse aktivizimi i potencialeve turistike viteve të fundit ka bërë që një numër i rugovasve të kthehen për të ndërtuar shtëpi dhe vila, për qëndrim sezonal dhe turizëm.

Rugova ka kulturë të veçantë materiale e shpirtërore dhe sidomos folklor të pasur. Dallohet për nga mënyra e jetesës, veshjet popullore (tirqit, plisi dhe shalli i bardhë), e folmja, mënyra e të ushqyerit etj. Në jetën sociale dhe ekonomike zbatoheshin normat dokësore (kanuni). Shtëpitë të ndërtuara me pullaze lugjesh druri, me dritare të vogla, përdhese, shpesh me ahure, pastaj tabanët (stanet) si forma të jetës sezonale dhe kullat ishin karakteristike e peizazhit rugovas. (Hivzi Islami)

RUGOVA Arben (1972-). Gazetar. Lindi në Plavë, në Mal të Zi. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, ndërsa studimet i përfundoi në Universitetin e Tiranës (1988). Filloi të shkruajë qëkur ishte student i gazetarisë. Si gazetar i rregullt filloi të punojë nga viti 2002 në gazetën “Koha ditore”. Më pas ishte njëri nga themeluesit e “Gazetës Express”,

ndërsa në periudhën 2004-2010 ishte redaktor dhe kryeredaktor i gazetës së përditshme “Lajm”. Më pas, për tri vjet ishte redaktor përgjegjës i portalit “Telegrafi.com”, kurse për një vit drejtoi edhe gazetën “Tribuna”. Nga viti 2014 është kryeredaktor i portalit “Lajmi.net”. Mori pjesë në specializime dhe trajnime të mbajtura në vende të ndryshme të Europës dhe në SHBA. (Ibrahim Berisha)

RUGOVA Bardh (1974-). Gjuhëtar, publicist, profesor, anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës. Lindi në Pejë. Shkollimin fillor dhe të mesëm i përfundoi në Prishtinë. U diplomua në Universitetin e Prishtinës (1997), ku kreu edhe studimet pasuniversitare dhe më 2006 mbrojti tezën e disertacionit të doktoratës për gjuhën e gazetave në Kosovë, që u botua në formë monografie më 2009. Punoi në gazetën “Koha ditore” nga viti 1998 deri më 2011. Nga viti 2002 ka qenë redaktor, ndërsa nga viti 2008 zëvendëskryeredaktor i kësaj gazete. Një pjesë të shkrimeve publicistike i ka publikuar në përmbledhjen “Me sebep” më 2011. Botoi romanin “Edmond Rugova: Rrëfimet e të dielave” (2010). Në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës, departamenti i gjuhës shqipe, ka filluar të punojë më 1999. Mban titullin profesor i asociuar. Ishte sekretar i Seminarit Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare (2000-2010) dhe drejtor i tij në periudhën 2011-2014. Është anëtar i Këshillit Ndërkademiq të Gjuhës Shqipe dhe sekretar i AIESEE-Kosovës. Ka mbajtur ligjërata në Universitetin e Munihut dhe të Napolit, si dhe ka përkthyer një pjesë të punimeve të Erik Hempit në përmbledhjen botuar në Prishtinë më 2006, si dhe veprën “Deluzionit Zot” të Riçard Dakinsit (2014). Interesimet e tij studimore përfshijnë tema të gramatikës së tekstit, të analizës së diskursit dhe të fonologjisë. Botoi punime për klasifikimin e mbiemrave të shqipes dhe për kohët e foljeve. Botoi monografinë “Shqipëria dhe shqiptarët në ‘New York Times’ në kohën e shpalljes së pavarësisë (1911-1913)” (2014) dhe “Hyrje në gramatikën e tekstit të gjuhës shqipe” si bashkautor (2015). (Imri Badallaj)



BARDH RUGOVA

RUGOVA Edmond (1957-). Futbollist. Lindi në Pejë. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Prishtinë, kurse Shkollën e Lartë Komerciale në Pejë. Në moshë 9-vjeçare filloi karrierën e futbollitit në KF “Pionieri” të Prishtinës, kurse si 16 vjeç debutoi për skuadrën e parë të KF “Kosova” nga Obiliqi. Një kohë luajti edhe për “Lirinë” e Prizrenit, kurse më pas kalon në radhët e “Prishtinës” dhe i takon “brezit të artë” të kësaj skuadre. Nga viti 1985 shpërngulet në Nju-Jork të SHBA-së, ku vazhdoi të luajë për “Nju-Jork Kozmos” (New York Cosmos) e më vonë edhe në “Kanzas Siti Komets” (Kansas City Comets). Ka qenë menaxher i një kompanie për zhvillimin e futbollit dhe themelues i shkollës së futbollit në Kanzas. Për një kohë u kthye në Kosovë, ku emërohet përzgjedhës i përfaqësueses së Kosovës, e më pas edhe drejtor i përgjithshëm i KF “Prishtina”. Jeton në SHBA. (Baki Berisha)

RUGOVA Ibrahim (1941-2006). President i Republikës së Kosovës, politikan, shkrimtar. Lindi në fshatin Cerrcë, komuna e Istogut. Kur ishte njëvjeçar, komunistët jugosllavë ia pushkatuan të atin (Ukë Rugova) dhe gjyshin (Rrustë Rugova). Pas shkollimit fillor në vendlindje, mbaroi shkollimin e mesëm në Pejë, kurse studimet i kreu në degën e gjuhës dhe të letërsisë shqipe të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës (1971). Ishte redaktor në gazetën e studentëve “Bota e re” dhe në revistën shkencore “Dituria” (1971-72). Pas diplomimit, për dy dekada punoi në Institutin Albanologjik të Prishtinës si hulumtues në fushën e letërsisë. Për një kohë ishte edhe kryeredaktor i revistës “Gjurmime albanologjike”, botim i këtij Instituti. Një vit akademik (1976/77) qëndroi në Paris, në Ecole Pratique des Hautes Etudes. Doktoroi më 1984 në fushën e letërsisë në Universitetin e Prishtinës. Deri në fund të viteve ’80 të shekullit të kaluar, I. Rugova zhvilloi aktivitet të dendur letrar. Në vitin 1988 u zgjodh kryetar i Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës, e cila u bë bërthamë e fuqishme e lëvizjes shqiptare, që kundërshtonte sundimin komunist serb dhe jugosllav në Kosovë. Nga krijimtaria e tij letrare,



IBRAHIM RUGOVA

Deri në fund të viteve ’80 të shekullit të kaluar, I. Rugova zhvilloi aktivitet të dendur letrar. Në vitin 1988 u zgjodh kryetar i Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës, e cila u bë bërthamë e fuqishme e lëvizjes shqiptare, që kundërshtonte sundimin komunist serb dhe jugosllav në Kosovë. Nga krijimtaria e tij letrare,

veçohen librat: “Prehje lirike” (1971), “Kah teoria” (1978), “Strategjia e kuptimit” (1980), “Vepra e Bogdanit 1675-1685” (1982), “Refuzimi estetik” (1982), “Refuzimi estetik” (1987), “Pavarësia dhe demokracia” (1991) etj. Më 1996 u zgjodh anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Në vitin 2005 Shtëpia Botuese “Faik Konica” e Prishtinës botoi kompletin e veprave të I. Rugovës në tetë vëllime.


Në jetën politike I. Rugova hyri më 23 dhjetor 1989, kur u zgjodh kryetar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), partisë së parë politike në Kosovë, e cila sfidoi drejtpërdrejt regjimin komunist në fuqi. Nën udhëheqjen e tij LDK-ja, në bashkëpunim me forcat e tjera politike shqiptare në Kosovë dhe me Kuvendin e atëhershëm të Kosovës, përmbylli kornizën ligjore për institucionalizimin e pavarësisë së Kosovës, me Deklaratën e Pavarësisë (2 korrik 1990), me shpalljen e Kosovës republikë (miratimi i Kushtetutës më 7 shtator, 1990), me referendumin popullor për pavarësinë dhe sovranitetin e Kosovës (shtator 1991), me zgjedhjet e para shumëpartiake për Kuvendin e Kosovës dhe me zgjedhjet presidenciale në Republikën e Kosovës (24 maj 1992). Në ato zgjedhje të para postkomuniste në Kosovë, LDK-ja fitoi shumicën e vendeve në Kuvend, ndërsa I. Rugova u zgjodh Kryetar i Republikës së Kosovës. Në zgjedhjet e dyta në mars të vitit 1998, u rizgjodh Kryetar i Republikës së Kosovës, kurse partia që e kryesonte, LDK-ja, fitoi shumicën e vendeve në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Gjatë bombardimeve të NATO-s kundër Serbisë, I. Rugova qëndroi me familjen e tij në Prishtinë, si peng i pushtuesit serb. Në gjendjen e arrestit shtëpiak do të detyrohej të takonte në Beograd ish-kryetarin e RFJ-së, S. Millosheviqin dhe, nën presion, të nënshkruante një deklaratë për ndaljen e bombardimeve të NATO-s. Në fund të periudhës së bombardimeve u largua nga Kosova, me ndihmën e Qeverisë Italiane dhe deri në çlirimin e Kosovës qëndroi me familjen në Romë. Pas hyrjes së trupave të KFOR-it u kthye në Kosovë dhe u bë pjesë e institucioneve transitore të Kosovës në periudhën e UNMIK-ut. Në zgjedhjet e organizuara nga UNMIK-u, LDK-ja nën udhëheqjen e I. Rugovës fitoi në zgjedhjet lokale (në tetor të vitit 2000) dhe në zgjedhjet e para të përgjithshme (2001). Në vitin 2002

I. Rugova u zgjodh president i Kosovës dhe u rizgjodh në këtë post në vitin 2004.

Si mbështetës i opsionit paqësor për zgjidhjen e çështjes së Kosovës gëzoi përkrahje të institucioneve të ndryshme ndërkombëtare dhe u nderua me shumë çmime prestigjioze: Çmimi për paqe i Fondacionit Paul Litzer në Danimarkë (1995), Doktor Honoris Causa i Universitetit të Parisit VIII në Sorbonë, Francë (1996), Çmimi “Saharov” i Parlamentit Europian (1998), Çmimi për paqe të qytetit Münster, Gjermani (1999) dhe u shpall qytetar nderi i qyteteve italiane: Venecia, Milano dhe Breshia, pastaj Çmimi për paqe i Unionit Demokratik të Katalonisë “Manuel Carrasco i Formiguera”, Barcelonë, Spanjë (2000), Çmimi i Europës për vitin 2004 (i Fondacionit Paneuropian Couenhove-Kalergi), Senator Nderi i Europës nga Senati i Europës (Atverpen, 2004) dhe çmimi nga Këshilli i Qytetit të Nju-Jorkut (2005).

I. Rugova ushtroi postin e presidentit të Kosovës deri më 21 janar 2006, kur ndërroi jetë në Prishtinë. Në ceremoninë varrimit të tij morën pjesë personalitete të njohura politike dhe burrështetas të shumtë nga bota. (Blerim Reka)

RUGOVA Mujë (1945-). Kimist, profesor universiteti. Lindi në Haxhaj, Pejë. Arsimimin bazë e mori në vendlindje dhe në Pejë, studimet i mbaroi në Fakultetin e Shkencave Matematike-



MUJË RUGOVA

Natyrore (FSHMN) të Universitetit të Prishtinës (1970). Studimet pasuniversitare për kimi fizike me radiokimi dhe tezën e disertacionit e mbrojti në FSHMN të Universitetit të Zagrebit (1981). Që në vitin 1971 zgjidhet asistent në degën e kimisë të Fakultetit Filozofik, ku më pastaj po në këtë degë të FSHMN-së do t'i marrë të gjitha gradat universitare. Ka ushtruar funksione dhe detyra me përgjegjësi në institucionet e arsimit të lartë në Kosovë, përfshirë edhe atë të rektorit të Universitetit të Prishtinës (2009-2012). Ka publikuar disa punime shkencore e kumtesa dhe është autor i një teksti universitar (“Kimia inorganike”). (Nexhat Daci)

RUGOVA Rustem (1946-). Gazetar. Lindi në fshatin Cerrcë të Istogut. Arsimin fillor

e kreu në Istog, shkollën normale në Pejë, ndërsa studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin Filozofik të Prishtinës. Në gazetën “Rilindja” filloi të punonte nga viti 1973, së pari si korrespondent nga Istogu dhe më pas gazetar në redaksi në Prishtinë. Shkroi raporte për ngjarjet e ndryshme nga forumet politike të vendit, nga proceset gjyqësore etj. Për punën profesionale u nderua me një sërë çmimesh dhe mirënjohjesh. Pas luftës së vitit 1999 punoi në gazetën “Bota sot” dhe në të përditshmen “Zëri”. Është autor i librit historiografik “Varret e përbashkëta” (1997) dhe i librit publicistik “Kujtime nga fëmijëria dhe rinia e Ibrahim Rugovës” (2013). (Ibrahim Berisha)

RUGOVA Safete (1946-). Aktore. Lindi në Gjakovë. Shkollën fillore e mbaroi në vendlindje, ndërsa gjimnazin në Prishtinë. Mbaroi studimet për aktrim në Shkollën e Lartë Peda-



SAFETE RUGOVA

gogjike dhe studimet për gjuhë e letërsi shqipe në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Në Teatrin Popullor Krahinor (TPK) u angazhua që në vitin 1968 dhe që atëherë luajti në një sërë shfaqjesh teatrore, si “Mbreti Edip” (1970), “Perkolgjinajt” (1970), “Gjenerali i ushtrisë së vdekur” (1972), “Ana Karenina”, “Hamleti” (1981), “Varri i qyqes” (1983), “Babai” (1997) “Komploti Ilir” (2004) etj. Luajti edhe në filmat e metrazhit të gjatë: “Përroi vërshues” (1981), “Kur pranvera vonohet” (1980), “Njeriu prej dheu” (1984) etj. Në vitin 2011, në TKK luajti rolin kryesor në shfaqjen “Nata e Helverit” në regji të A. Bashës. Pas vitit 2000, përmes Shoqatës “Motrat Qiriazit” realizoi disa shfaqje dhe projekte të tjera teatrore, kryesisht me tematikë për të drejtat e gruas. Për kontributin e saj si aktore, në vitin 2012 u dekorua me Medaljen Presidenciale të Meritave. (Besim Rexhaj)

RUGOVËS (E FOLMJA E). Bën pjesë në grupin veriperëndimor të të folmeve geqe, mirëpo për disa elemente përkon edhe me gegërishten verilindore, përkatësisht me të folmet e Kosovës. Përkatësia veriperëndimore e saj dëshmohet me ruajtjen e disa prej tipareve më karakteristike të këtij grupi të folmesh, ndërkohë

që përkimi me gegërishten verilindore është rezultat i kontaktit të përhershëm gjuhësor dhe i migrimit të popullatës nga bjeshka në vendbanime të rrafshëta, vende ku flitet gegërishtja verilindore. Në fushë të morfologjisë dhe të sintaksës del mjaft unike, ndërkohë që në fushë të fonetikës vërehen dallime, por jo në përmasa të theksuara. Ka një inventar prej 18 fonemash zanore dhe 28 fonemash bashkëtingëllore. Gjatësia e zanoreve dhe hundorësia kanë vlerë fonologjike. Rotacizmi del te përemri i pacaktuar *njâri<njëri*, pastaj te *ndonjâri* dhe *asnjâri*. Fonema ë tek mbiemrat e formuar me prapashtesën *-shëm* është alternuar në fonemën *i*, si: *i moçim-i moçëm*, *i sjellshim-i sjellshëm*. Në këtë të folme ruhet diftongu *ua*: *grua*, *krua*, *prua* te emrat që përfundojnë me rrokje të hapur; te pjesorja e foljeve: *xhua*, *fillua*, *pûnua*; te koha e tashme: *dua*, *drua*, ndërkohë që në këtë areal gjuhësor del paralelisht edhe togu zanor *ue* i gegërishtes verilindore: *grue*, *bluej*, *msues*. Tingulli *nj* ka kaluar në *-j*. Ruhet vetëm te disa përemra të pacaktuar, si: *njâra*, *ndonjëri*. Qiellzoret *q-gj*, si në të folmet e gegërishtes verilindore, kanë kaluar në afrikatet *ç* dhe *xh*. Fonemat *r* dhe *R* ruhen dhe krijojnë kundërvënie fonologjike. Grupet e vjetra *kl* dhe *gl* kanë dhënë *kj* dhe *gj*, p.sh.: *kjumsht* dhe *gjuha*. Në këtë areal togu konsonantik *mb* jep tri reflekshe: *mb-b*; *mb-m* dhe *mb-p*. Të njëjtën rrugë zhvillimi ka ndjekur edhe togu *nd*. Togjet *ng* dhe *ngj* janë reduktuar në elementin e dytë, të cilët kanë evoluar përfundimisht në fonemat *k* dhe *ç*, p.sh.: *cung-cûk* dhe *ngjyey-çyey*. Në këtë të folme shpesh ndodh edhe shurdhimi i bashkëtingëlloreve të zëshme në fund të fjalës, tipar ky qenësor i toskërishtes. Përdoren dendur emrat e prejardhur nga substantivimi i mbiemrave foljorë, p.sh.: *t'ardhunit*, *d'vramit*. Emrat e tipit *krua*, *ftua*, *thua* në rasën kallëzore të pashquar e ruajnë togun *ua*, ndërsa në të shquarën e rrudhin në *o*, p.sh. *krua/kroni*. Përemri vetor *unë* del në trajtën *û*. Në këtë të folme përdoret përemri pyetës *i sejt*. Del edhe aoristi sigmatik, si p.sh. *ra:sh*, *pa:sh*. Kohët analitike të dëftores: e kryera, më se e kryera dhe e kryera e tejskkuar dalin me nga dy forma, d.m.th. e kryera e parë: *kâ la*: dhe e kryera e dytë: *kâ pa la*; më se e kryera e parë: *kisha la*: dhe më se e kryera e dytë: *kisha pa la*; si dhe koha e kryer e tejskkuar e parë: *pata la*: dhe e kryera e tejskkuar e dytë: *pata pa la*:. Funkcionet e lidhores i mbulon paskajorja, ndërsa

përcjellorja ndërtohet me pjesëzën *tye+pjesorja* e foljes p.sh.: *Ishna tye te:j*. E folmja e Rugovës shtrihet në 13 katunde malore, ndërsa folësit e saj, edhe pse të zbritur shumica në tokat pjellore të rrethit të Pejës, pavarësisht nga mosha, ruajnë të folmen e tyre. (Haki Hysenaj)

RUKIQI Mehmet (1936-). Mbledhës dhe studiues i folklorit. Lindi në Verboc të Drenicës. Shkollën fillore e kreu në Gillogoc, Shkollën Normale dhe Fakultetin e Filozofisë, degën e letërsisë dhe të gjuhës shqipe i mbaroi në Universitetin e Prishtinës, ku kreu dhe studimet pasuniversitare dhe mbrojti tezën e doktoratës. Ishte mësues dhe mësimdhënës në disa shkolla në Drenicë, kurse nga viti shkollor 1972/73 u punësua në Shkollën teknike “19 Nëntori” në Prishtinë, por u përjashtua nga puna për arsye politike. Punoi si përkthyes deri në pensionim në Kuvendin Komunal të Prishtinës. Nga folklori i mbledhur në Drenicë ka botuar tetë vëllime me anekdota: “Anekdotat popullore” (2001-2015) dhe dy vëllime “Këngë dasme” (2009). Ka botuar edhe veprat studimore “Krijues dhe bartës të tregimeve popullore në Drenicë” (1998), pastaj monografitë “Tahir Berisha” (2008) dhe “Azem Galica” (2013) etj. (Adem Zejnullahu)

RUKOVCI Nezaqete (1956-). Gazetare. Lindi në Prishtinë. Shkollimin fillor dhe gjimnazin i kreu në Prishtinë, ku mbaroi edhe studimet për gazetari dhe diplomaci në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës (1997). Nga viti 1976 punoi gazetare në gazetën e përditshme “Rilindja”, ndërsa nga viti 1992 në gazetën “Bujku” si redaktore-gazetare. Pas rihapjes së “Rilindjes” (1999), vazhdoi punën e gazetares, e në vitin 2000, krahas punës në gazetë, hapi emisionin “Gruaja dhe familja” në kuadër të “Radio-Rilindjes”. Gjatë punës në gazetari trajtoi tema që lidhen me pozitën dhe barazinë e gruas në Kosovë. Bashkëpunoi edhe me gazeta dhe revista të tjera në Kosovë dhe në diasporë. Më pas kaloi me punë në Ministrinë e Kulturës, si zyrtare për barazi gjinore dhe mundësi të barabarta. (Veli Bytyçi)

RUKS Mishel (Michel Roux) (1943-2009). Studiues dhe profesor në Universitetin të Tuluzit - Le Mirail. Lindi në Aurillac, departamenti i Cantal-it në Francën Jugore. Studioi gjeografinë dhe gjeopolitikën në Sorbonë, ku u diplomua në vitin 1966. Interesimi i tij për



MISHEL RUKS

dhe veçanërisht për Kosovën dhe shqiptarët në trevat e ish-Jugosllavisë. Bëri doktoratën shtetërore me titull “Shqiptarët në Jugosllavi” (Les Albanais en Yougoslavie), që u botua në vitin 1992. Menjëherë pas çlirimit të Kosovës, në vitin 1999, botoi edhe librin tjetër me titull “Kosova-dhjetë çelësa për ta kuptuar” (Le Kosovo-dix clés pour le comprendre). Publikoi edhe shumë artikuj, studime dhe shkrime në revista të ndryshme shkencore dhe veçanërisht në ato politikologjike, si dhe në gazeta ditore të Francës dhe jashtë saj, për Kosovën dhe shqiptarët. Mori pjesë në shumë tryeza, konferenca dhe debate për Kosovën në vitet ‘90 dhe pas luftës së Kosovës. Ndikimi i tij, në favor të Kosovës dhe shqiptarëve ishte i madh dhe në sferën politike dhe ushtarake. Për kontributin e tij shkencor dhe angazhimet politike në të mirë të Kosovës dhe pavarësisë së saj, në vitin 2000 Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës e zgjodhi anëtar të jashtëm të saj. Vdiq dhe u varros në Braks, afër Tuluzit. (Hivzi Islami)

RUNIKU. Fshat në Drenicë, rreth 14 km në veriperëndim të Skënderajt. Shtrihet përgjatë rrugës magjistrale Pejë-Mitrovicë, në lartësinë mbidetare 680 m. Sipërfaqja e komunës kadastrale 1,135 ha. Përmes magjistrals Pejë-Mitrovicë lidhet me Istogun dhe qendrat e tjera të Rrafshit të Dukagjinit, ndërsa nëpërmjet fshatit Llaushë lidhet me Skënderaj. Është ndër vendbanimet më të vjetra të Drenicës dhe Kosovës në përgjithësi. Gërmadhat e kështjellës, të njohur me emrin Gradishte, që ndodhen në ngatrën e fshatit dëshmojnë për vjetërsinë e vendbanimit. Runiku në vitin 1921 kishte 423 banorë, në vitin 1948 numëronte 764 banorë, ndërsa në regjistrimin e fundit (2011) kishte 1,586 banorë. Popullsia merret me bujqësi dhe blegtori. Kultivohen drithërat, pemët dhe perimet. Ka disa dyqane tregtare e zejtare. Është bashkësi lokale në të cilën gravitojnë vendbanimet: Banjë, Çitak, Kastriot (Kostërc),

Leqinë, Pemishtë (Padalishtë), Radishevë dhe Syrganë. Me planin zhvillimor komunal, Runiku shndërrohet në nënqendër urbane, e cila përfshin edhe vendbanimet: Qubrel, Lekaj (Rakinicë) dhe Vitak. Nga objektet e standardit shoqëror, Runiku ka shkollën 9-vjeçare, shkollë të mesme profesionale, qendër shëndetësore të mjekësisë familjare, qendrën e veterinarisë, disa njësi tregtare etj. (Ramiz Cërvadiku)

RUSAKOV Aleksandar (Jurevič) (1957-). Gjuhëtar rus, profesor, albanolog, ballkanolog. Lindi në Leningrad (Shën Peterburg). Kreu studimet e larta në degën e gjuhës dhe të letërsisë shqipe të Fakultetit të Filologjisë të Universitetit Shtetëror të Leningradit (1979). Më 1980 nis të punojë në Institutin e Gjuhësisë të Akademisë së Shkencave (dega e Leningradit, nga viti 1992-Instituti i Studimeve Linguistike). Më 1992 filloi punë në katedrën e gjuhësisë së përgjithshme dhe më 2001 u vu në krye të degës së shqipes. Interesat kërkimore-shkencore i ka në një varg të gjerë fushash: historia e gjuhës dhe e letërsisë shqipe, gramatika e shqipes, kontaktet e shqipes me gjuhët përreth, gjuhët ballkanike, gjuha rome. Studimet e realizuara i shërbejnë si bazë për të nxjerrë përfundime në rrafshin e përgjithshëm të gjuhësisë indoeuropiane, tipologjisë linguistike dhe studimeve të kontakteve gjuhësore. Është autori i artikujve të shumtë kushtuar gjuhës së teksteve të vjetra shqipe, fonetikës historike, dukurive ballkanike dhe veçorive tipologjike të shqipes. Me disertacionin “Interferenca gjuhësore dhe ndërrimi i kodeve (dialekti rom i Veriut të Rusisë nga pikëpamja e kontakteve gjuhësore)” (Interferencija i pereklučenje kodov (severnoruskij dialekt ciganskogo jazyka v kontaktologičeskoj perspektive) mori gradën doktor i shkencave filologjike (2004). Kryeson projektin “Korpusi nacional i gjuhës shqipe”. Merr pjesë në aktivitete të ndryshme shkencore në fushën e albanologjisë dhe ballkanologjisë, përfshirë Seminarin e Gjuhës, Letërsisë dhe Kulturës Shqiptare në Prishtinë. Botoi një sërë punimesh për gjuhën shqipe, kryesisht në fushën e sistemit foljor. (Marija Morozova)

RUSI Lutfi (1923-1981). Lindi në Dibër (Maqedoni). Mësimet e para i mori në vendlindje. Mori pjesë aktive në Luftën e Dytë Botërore. Pas lufte ka punuar gazetar në Radio-Shkup dhe

redaktor përgjegjës e kryeredaktor në gazetën e vetme të përditshme në gjuhën shqipe në Maqedoni “Flaka e vëllazërimit”, derisa u pensionua. Shkroi tregime, monografi, romane, kujtime dhe ka përkthyer një varg librash nga letërsia, publicistika dhe materialet didaktike. Në vitin 1952 bashkë me Mehmedali Hoxhën botoi përmbledhjen për fëmijë “Vjersha”. Pas saj botoi librat: “Brigada e lepujve” (1968), “Rrëfime partizane” (1974), “Mbrujtja” (1975), “Dy shokët (1977), “Dëshmi” (1977), “Ibe Palikuja” (1979), “Shurdhmemeci” (1981). Është bashkautor i Fjalorit maqedonisht shqip (me M. Qorveziroskin). Edhe pse pjesën më të madhe të punës e bëri në fushën e gazetarisë, ai shquhet si krijues i fillimeve të letërsisë për fëmijë në gjuhën shqipe në ish-Jugosllavi. (Fatmir Sulejmani)

RUSI Myqereme (1958-). Psikologe, profesore universiteti. Lindi në Tetovë, ku kreu edhe shkollën fillore dhe të mesme. Studioi psikologjinë në Universitetin e Shkupit. Në vitin 1996 magjistroi, ndërsa në vitin 1997 doktoroi në Fakultetin e Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës. Ishte ndër themeluesit e Universitetit të Tetovës, ku fillimisht punoi si asistente, më pas edhe mësimdhënëse e psikologjisë. M. Rusi ishte mësimdhënëse edhe në Fakultetin e Mësuesisë dhe në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Si aktiviste për të drejtat e shqiptarëve në Maqedoni, në vitin 1992 u zgjodh kryetare e Lidhjes së Gruas Shqiptare në Maqedoni. Ishte pjesëmarrëse në konferenca shkencore dhe botoi disa punime shkencore. Është bashkautore e teksteve “Metodika e edukimit parashkollor” (1999) dhe “Psikologjia medicinale” (2012). (Hatixhe Vojka-Ismajli)

RUSINOVCI Adem (1967-). Skulptor. Lindi në Prishtinë. Mbaroi shkollimin fillor dhe të mesëm në Prishtinë. Kreu Fakultetin e Arteve, degën e skulpturës po ashtu në Prishtinë. Është mësimdhënëse në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës (UP). Hapi një sërë ekspozitash personale, ndër të cilat veçohen: në Shkup në Muzeun e Arteve Bashkëkohore (1995), në Prishtinë në Galerinë e Arteve të Kosovës (2005, 2010), pastaj ekspozita në ambient të hapur pranë Rektoratit të UP-së etj. Mori pjesë në një sërë ekspozitash të përbashkëta në vend dhe në botën e jashtme, si në sallonet pranverore,



ADEM RUSINOVCI

në ekspozitat e rregullta vjeshtore, në Bienalen Ndërkombëtare të Vizatimit etj. Mori pjesë në manifestime kulturore ndërkombëtare, si në SHBA, Britani të Madhe, Gjermani, Portugali, Spanjë, Poloni etj. Është fitues i disa çmimeve profesionale nga fusha e arteve pamore, filmike dhe konceptuale, si në: SEE Film Festival, Paris (2012), në Bienalen e Vizatimit (2006), pastaj çmimin e parë në Sallonin e Nëntorit (2001) etj. Vepra e tij është pjesë e Fondit të artistëve të shekullit XX në Muzeun e Artit Bashkëkohor të Shkupit. (Agim Rudi)

RUSTEMI Ferit (1947-). Gjuhëtar, profesor. Lindi në Tetovë, ku kreu shkollën fillore dhe të mesme. U diplomua për gjuhë dhe letërsi angleze në Universitetin e Shkupit. Studimet pasuniversitare i mbaroi në Universitetin e Zagrebit, ndërsa studimet e doktoratës i ndoqi në SHBA (1985). Temën e doktoraturës e mbrojti në Prishtinë (2003). Punoi në gjimnazet e Ferizajt dhe të Tetovës. Në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës punoi nga viti 1975, ndërsa më 1983 u zgjodh ligjërues. Si lëndë kryesore mbajti gjuhësinë e përgjithshme dhe historinë e gjuhës angleze. Botoi një varg punimesh që lidhen me çështje të standardizimit të gjuhës dhe të kontakteve të shqipes me anglishten. Punoi edhe në Universitetin e Europës Juglindore në Tetovë. (Linditë Rugova)

RUSHITI Burbuqe (1961-). Gazetare. Lindi në Prishtinë. Shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në Prishtinë, më pas studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Prishtinës. Për disa vite ishte gazetare dhe moderatore e programeve të ndryshme të Radio Prishtinës deri në dëbimin e shqiptarëve nga institucionet më 1990. Gjatë viteve '90 punoi për agjenci dhe medime të ndryshme. Më 1999 botoi në Stamboll librin "Më mungon era e Kosovës", ndërsa më 2006 përmbledhjen me poezi "E diela në dhomën time". Është korrespondente për Ballkan e Televizionit turk NTV. (Nehat Islami)

RUSHITI Hasim (1962-). Profesor universiteti në fushën e sportit. Lindi në Rashincë të

Shtimes. Kreu Fakultetin e Shkencave Sportive në Prishtinë më 1986. Studimet pasuniversitare i regjistroi në Fakultetin e Kulturës Fizike të Universitetit të Zagrebit, ndërsa i përfundoi në Universitetin e Prishtinës më 1999. Dy vjet më vonë (2001) arrin gradën e doktorit të shkencave sportive. Që nga viti 1987 ka punuar mësimdhënës në Fakultetin e Kulturës Fizike të Universitetit të Prishtinës, duke i arritur të gjithë titujt universitarë, përfshirë edhe titullin profesor i rregullt (2013). Është autor dhe bashkautor i punimeve profesionale dhe shkencore nga fusha e sportit. (Albatri Matoshi)

RUSHITI Liman (1942-). Historian. Lindi në fshatin Sazli të Ferizajt. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Ferizaj, ndërsa në Prishtinë mbaroi studimet për histori në Fakultetin Filozofik të Prishtinës (1967). Po në atë vit u zgjodh asistent në Entin e Historisë së Kosovës. Më pas kreu studimet pasuniversitare, mbrojti temën e disertacionit të doktoratës (1980) për lëvizjen kaçake në Kosovë. Punoi në Institutin e Historisë të Kosovës dhe botoi një sërë punimesh në revista shkencore, si dhe mori pjesë në shumë simpoziume e kongrese shkencore në Kosovë e jashtë saj. Është autor i disa monografive historike dhe teksteve shkollore për lëndën e historisë. Ndër veprat e botuara veçohen: "Lëvizja Kaçake në Kosovë 1918-1928" (1981), "Rrethana politiko-shoqërore në Kosovë 1912-1918" (1986), "Kujtime për Lëvizjen Kaçake" (2003), "Ndarja territoriale dhe rregullimi administrativ i Kosovës 1878-1941" (2004) etj. Është bashkautor në veprën "Historia e popullit shqiptar III", botim i Akademisë së Shkencave dhe i Instituti i Historisë së Shqipërisë (2007). (Fitim Rifati)

RUSHITI Mulla Kadri (1905-1979). Teolog islam, atdhetar. Lindi në fshatin Llashticë të Gjilanit. Mësimet e para i mori në vendlindje, më pas i vazhdoi më 1918 në Medresenë "Atik" po në Gjilan. Pas medresesë u angazhua si pedagog në mejtepin e Zhegrës (1928-1930), ndërsa më vonë u emërua në detyrën e kryeimamit, përkatësisht të inspektorit të xhamive për rrethinën e Gjilanit. I përket brezit të atdhetarëve, që nuk u pajtua me aneksimin e Kosovës nga Serbia dhe gjatë vitit 1943-44 mori pjesë në luftën e Preshevës për mbrojtjen e kufirit nga Serbia. Ka qenë

anëtar dhe mbështetës i Organizatës Nacional Demokratike Shqiptare. Për shkak të aktivitetit patriotik, u burgos më 1944, ndërsa pas daljes nga burgu iu përkushtua profesionit të imamit, detyrë që e kreu në disa fshatra të Anamoravës. Luajti rol të rëndësishëm në pajtimin e ngatërresave e gjaqeve, u angazhua kundër shpërnguljes së shqiptarëve në Turqi dhe ishte mbështetës i madh i masivizimit të shkollës shqipe. Në popull njihet edhe si Mulla Kadri Llashtica. (Ramadan Shkodra)

RUSHITI Mustafë (1936-). Gazetar. Lindi në Prishtinë, ku kreu shkollën fillore, gjimnazin dhe Fakultetin e Drejtësisë. Fillimisht ishte nëpunës banke, ndërsa nga viti 1958 nis punë në gazetën "Rilindja". Në redaksinë e kësaj gazete ushtroi detyra të ndryshme, si redaktor, ndihmës i kryeredaktorit, zëvendëskryeredaktor etj. Shkroi lajme, komente e analiza sidomos nga fusha e politikës. Për shumë vjet bashkëpunoi dhe më vonë edhe e drejtoi gazetën "Zëri i rinisë". Po ashtu ka shkruar edhe për botimet e tjera të "Rilindjes", si "Shkëndija", "Fjala", "Kosovarja" etj. Një kohë ka qenë korrespondent i agjencisë jugosllave të lajmeve "Tanjug" nga Kosova. Nga vitet '90 jeton në SHBA. (Zenun Çelaj)

RUSHITI Sulejman (1972-). Regjisor. Lindi në Gostivar, ku kreu shkollën fillore dhe të mesme. Studimet për regji i kreu në Akademinë e Arteve në Tiranë. Bëri regjinë teatrore të veprave: "Makina Hamlet" nga H. Myler (1996), "Policët" të S. Mrozhekut (1997), "Mësimi i Badenit mbi pajtimin" nga B. Breht (1997), "Vdekja e bukur" e M. Matishiçit (1998), "Çifti i hapur" e D. Fo (1998), "Të ikësh larg nga gruaja jote" e R. Kuni (1998), "Genti" nga Sh. Delvina (2000), "Muzeu" nga K. Trebeshina (2001), "Kjo është lufta ime" nga A. Halimi (2002),



SULEJMAN RUSHITI

"Vepra e plotë e Shekspirit, e shkurtuar lehtë" nga A. Long, D. Singer dhe J. Uinfeld (2008), "Me grusht tehot të thikës" nga A. Boal (2011), "Djemtë gazmorë" nga N. Simon (2014) etj. Bëri edhe disa regji televizive. Ishte drejtor i Teatrit të Kombësive në Shkup, deputet në Parlamentin e Maqedonisë dhe ministër i Arsimit dhe i Shkencës. (Salajdin Salihu)

RUVARAC Ilarion (Arion Jovan Ruvarach) (1832-1905). Historian, arkimandrit dhe akademik serb, themelues i kritikës historiografike serbe. Lindi në Mitrovicë të Sremit (Vojvodinë). U diplomua për drejtësi në Universitetin e Vjenës (1856) dhe u dorëzua murg në Krushe-doll (1861), kur u pagëzua me ermin Ilarion. Më pas ishte kryemurg (arkimandrit) i Manastirit të Gërgetegut (Vojvodinë). I. Ruvarach u përcaktua për metodologjinë e studimit komparativ të historisë, duke pasur model historianin e shquar austriako-gjerman, Leopold von Ranke, dhe u bë themelues i kritikës së historiografisë serbe. Doli kundër historiografisë së romantizmit nacionalist serb, e cila nuk mbështetej në burime, por në traditën popullore, në jetëshkrimet e shenjtorëve, në legjenda dhe rrëfime popullore. Kritikoi Panta Sreçkoviçin, përfaqësuesi kryesor i kësaj historiografie. Po kështu polemizoi edhe me Milosh S. Milojeviqin, i cili u angazhua për organizimin e "Propagandës kombëtare në Serbinë e Vjetër" (Kosovë) etj. Ilarioni insistonte në leximin e drejtë të burimeve, sidomos të dokumenteve, si detyrë e parë e historianit dhe të vlerësohej në ato ishin origjinale, apo të falsifikuara. Shpërnguljen e Madhe Serbe të vitit 1690 e quajti "e ashtuquajtur". Kritikoi Gjuragj Brankoviçin dhe Arsenije Çarnojeviçin, që, sipas tij, kishin kontribuar për këtë shpërngulje. Duke u mbështetur në dokumente të kohës, zvogëloi shumëfish shifrën e të shpërngulurve, për dallim nga historianë të tjerë serbë. Për pikëpamjet e tij u akuzua si "rrënues i shenjtorëve dhe i mitit të Kosovës", "tradhtar", "armik i popullit serb" etj. Shkrimet e tij janë me interes për historinë shqiptare, sidomos të Kosovës. (Ramiz Abdyl)

RR

RRACI Mehdi (1942-). Inxhinier i arkitekturës. Lindi në Gjakovë, shkollimin fillor dhe të mesëm i kreu në vendlindje dhe në Prishtinë, ndërsa studimet në Fakultetin e Arkitekturës të Universitetit të Shkupit (1968). Pas mbarimit të studimeve punësohet në Kuvendin Komunal të Gjakovës, si urbanist kryesor, ku ka luajtur rolin kryesor në hartimin e planit urbanistik të komunës. Në vitin 1971 fillimisht angazhohet asistent në degën e ndërtimtarisë të Fakultetit Teknik të Universitetit të Prishtinës, pastaj ligjërues për lëndën konstruksionet arkitektonike. Ishte udhëheqës i Komisionit për hapjen e seksionit të arkitekturës në Fakultetin Teknik, punë që u kurorëzua me sukses në vitin 1978. Për shumë vjet ishte shëf i këtij seksioni në Fakultetin Teknik të UP-së. Është hartues dhe mbikëqyrës i shumë projekteve arkitektonike. (Flamur Doli).

RRAFSHI I DUKAGJINIT. Krahinë e madhe gjeografike e historike në pjesën perëndimore të Republikës së Kosovës. Njihet edhe me emrin fushëgropa e Dukagjinit. Rrethohet nga Mali i Thatë dhe Mokna në veri; nga Bjeshkët e Nemuna dhe Podguri i Pejës në perëndim; nga Malësia e Gjakovës në juglindje; Pashtriku, Malet e Sharrit e Podguri i Prizrenit në jug; dhe nga mali i Milanovcit, Llapusha dhe Kodrat e Drenicës në lindje. Paraqet një fushëgropë të madhe tektonike, e formuar në fillim të miocenit, me fundosjen e bazamentit të përbërë nga shkëmbinj të vjetër, përgjatë thyerjeve tektonike anësore. Ka formë harkore, gjatësi afër 75 km, gjerësi 15-30 km dhe sipërfaqe 3,000 km².

Korniza malore e Rrafshit të Dukagjinit është e ndërtuar kryesisht nga formacionet shkëmbore të moshës paleozoike dhe mesozoike, me



PAMJE E RRAFSHIT TË DUKAGJINIT

morfologji glaciale, karstike e të fluvio-denedimit.

Zona ultësinore (fushore) e Rrafshit të Dukagjinit është e ndërtuar nga sedimentet e miocenit, pliocenit dhe kuaternarit. Sedimentet e miocenit, të cilët paraqiten në rrethinën e Pejës, Runikut e Suhogërrllës, përfaqësohen nga mergelet, tufët, rërat, zhavorret dhe konglomeratet kokërrimët, me disa shtresa të holla të linjtit. Sedimentet e pliocenit, shtresat e të cilëve janë horizontale, kanë përhapje relativisht të madhe në rajonet e Pejës, Gjakovës e Prizrenit dhe përfaqësohen nga zhavorri, rërat dhe argjilat, në të cilët paraqiten edhe shtresa të trasha të linjtit (mbi 50 m) në rajonin e Klinës, në Gjonaj afër Prizrenit etj. Sedimentet liqenore, të përbëra nga zhavorret, rërat argjilat dhe depozitimet e tarracave dhe ato lumore (aluviale), të përfaqësuara nga zhavorret, rërat dhe argjilat, kanë përhapje relativisht të madhe dhe paraqiten në pjesët ultësinore të rrjedhës së Drinit të Bardhë dhe të degëve kryesore të tij. Zona ultësinore (fushore) e Rrafshit të Dukagjinit karakterizohet me morfologji kryesisht erozive dhe akumulative lumore dhe relief fushor me lartësi mbidetare 320-520 m.

Është e ndërprerë nga disa lugina lumore të sheshta, me rrafshje të gjera aluviale, tarraca lumore dhe rrafshje liqenore, të cilat e kanë kush-tëzuar ndarjen në rajonin verior, në rrjedhjen e sipërme të Drinit të Bardhë (fusha e Pejës dhe e Burimit, Lugu i Baranit), rajonin e mesëm, në rrjedhjet e Erenikut, të lumit Krena dhe Llukacit, nga Sukat e Cërmjanit dhe e Hereçit, deri te barriera gëlqerore e Gradishës (fusha e Gjakovës, Dushkaja, Anadrini) dhe rajonin e jugut të Rrafshit të Dukagjinit, nga Gradisha e deri në Prizren (fusha e Prizrenit, Podrima dhe fusha e Suharekës).

Klima e Rrafshit të Dukagjinit është më e ngrohtë, më e lagësht dhe me më shumë të reshura shiu e bore se sa e Fushës së Kosovës. Klima e mesme kontinentale zotëron në pjesët e ulëta fushore, ndërsa e mesme kontinentale me ndikim mesdhetar, përmes Drinit të Bardhë, zotëron në pjesën jugore. Temperatura mesatare e janarit është 0.5-1.0°C, e korrikut 21-23°C, ndërsa mesatare vjetore 11.0°C. Bien mesatarisht 700 mm reshje në vit. Erërat më të shpeshta janë ato të drejtimit perëndimor dhe jugperëndimor. Vlera mesatare vjetore e diellosjes në Pejë dhe në Prizren është 2,065 orë/vit.

Rrafshi i Dukagjinit dallohet për pasuri të mëdha ujore, të cilat përbëhen nga lumi Drini i Bardhë, i cili ka krijuar edhe kanionin tek Ura e Fshejtë, degët e tij (Bistrica e Pejës, e Deçanit, Lumëbardhi i Prizrenit, Ereniku, Klina, Toplluha) dhe burimet e shumta ujore buzë rrëzës, ndër të cilat më të rëndësishmet janë gurrat e Radavcit, e Istogut, e Vrellës, burimi i Ujit të Zi, i Studençanit, i Korishës, i Kushninit, i Vërmicës dhe burimi termomineral i Ilixhës së Pejës. Karakterizohet edhe me akuifere të rëndësishme të ujërave nëntokësore. Liqeni artificial i Radoniqit është krijuar në veri të Gjakovës, në afërsi të fshatit me të njëjtin emër. Në pjesën ultësinore të Rrafshit të Dukagjinit paraqiten tokat e murrme, të kuqërremta, të krijuara mbi sedimentet pliocenike (Pejë, Istog, Gjakovë, Baran, Prizren, Suharekë etj.) dhe tokat aluviale, mbi sedimentet e kuaternarit të luginave dhe tarracave të rrjedhave lumore. Janë tokat më pjellore që kanë mundësuar zhvillimin e bujqësisë intensive në Republikën e Kosovës. Bimësia natyrore e pjesës ultësinore përfaqësohet kryesisht nga dushku, plepi, verri, shelgjet, ndërsa ajo e kultivuar nga llojet e shumta të pemëve (gështenja, arra, hardhia e

rrushi, molla, dardha, kumbulla) dhe drithërat e ndryshëm (misri, gruri, elbi).

Rrafshi i Dukagjinit ka dendësi të madhe të popullsisë. Janë zhvilluar disa qytete të mëdha, si: Peja, Gjakova e Prizreni, si dhe një numër i qyteteve më të vogla dhe i vendbanimeve të shumta rurale. (Vahdet Pruthi)

RRAFSHI I KOSOVËS. Trevë gjeografike e historike në pjesën qendrore të Republikës së Kosovës. Njihet edhe si fushëgropa e Kosovës. Rrethohet nga malet e theksuara dhe kodrinat e



PAMJE E RRAFSHIT TË KOSOVËS

tyre. Kufizohet nga Kollashini e Shala e Bajgorës në veri; me malet e Zhegovcit, në lindje; me Sharrin dhe Karadakun e Shkupit, në jug; dhe me Çiçavicën, Goleshin dhe malet e Jezercit në perëndim. Paraqet një fushëgropë tektonike, e fundosur në fund të miocenit dhe fillim të pliocenit, relativisht e ngushtë dhe e zgjatur në drejtimin veriveriperëndim-jugjuglindje, që shtrihet nga Mitrovica e deri te Kaçaniku, me gjatësi afër 84 km, gjerësi mesatare prej 10-16 km, sipërfaqja afër 1,300 km² dhe lartësia mbidetare mesatare 550 m. Veçohet në pjesën veriore fusha e Mitrovicës dhe e Vushtrrisë, në pjesën qendrore rrafshi i Fushë-Kosovës dhe i Lipjanit dhe në pjesën jugore fusha e Ferizajt dhe e Kaçanikut.

Rrafshi i Kosovës ndërtohet kryesisht nga sedimentet e reja të pliocen-kuaternarit. Sedimentet e pliocenit të poshtëm përfaqësohen nga rërat e argjilat me linjit, në pjesët qendrore të fushëgropës dhe zhavorret, rërat dhe argjilat ranore, në pjesët anësore të saj. Sedimentet e kuaternarit, të cilat mbulojnë ato të pliocenit përgjatë rrjedhjeve të Sitnicës dhe Lepencit përfaqësohen nga sedimentet liqenore të pleistocenit, të përfaqësuara nga argjilat ranore

ngjyrë e kuqërremtë, zhavorret dhe rërat, që paraqiten në lindje të Ferizajt dhe sedimentet e tarracave lumore (zhavorr dhe rëra) përgjatë lumenjve kryesorë. Depozitimet proluviale në formë të grumbullimeve konike të çakëllit, të përzier me dhë, paraqiten në bregoret e ulëta anësore të fushëgropës së Kosovës, ndërsa depozitimet aluviale paraqiten në shtretërit e rrjedhjeve ujore (Lepenc, Nerodime, Sitnicë etj.).

Nga veprimtaria erozive lumore, e më pak nga veprimi i lëvizjeve të reja tektonike, sot Rrafshi i Kosovës është veçuar në pjesët e ultësirës dhe në pjesët të valëzuara kodrinore të ulët. Format e para janë të lidhura më së shpeshti me luginat e sheshta lumore, përkatësisht me pjesët qendrore, ndërsa format e tjera paraqiten në pjesët anësore të tij. Rrjeti lumor i Rrafshit të Kosovës është i konsiderueshëm, por lumenjtë e tij nuk janë të përhershëm dhe janë shumë të varur nga regjimi i të reshurave, prandaj për shkak të karakterit të tyre fushor, të luginave dhe të shtretërve të sheshtë dhe të cekët, përmbytin sipërfaqe të mëdha në pjesën qendrore. Lumi kryesor, Sitnica, i cili përshkon pjesën më të madhe të fushëgropës dhe me degët e saj më të rëndësishme (lumenjtë e Drenicës, Sazlisë, Zhegovcit, Janjevës, Llapit, Lushtës etj.), bart ujërat në drejtim të veriut për në Detin e Zi, ndërsa Lepenci, me degën e tij të Nerodimes rrjedh në drejtim të jugut. Për këtë arsye relievi i Rrafshit të Kosovës paraqet një ujëndarës ndërmjet Detit të Zi dhe detit Egje dhe ka kushtëzuar paraqitjen e bifurkacionit të lumit Nerodime afër Ferizajt. Rrafshi i Kosovës karakterizohet edhe me praninë e akuifereve intergranularë të ujërave nëntokësore.

Rrafshi i Kosovës ka klimë të theksuar kontinentale, me verë me temperaturë të lartë dhe të thatë, dimër të ftohët dhe relativisht të lagësht dhe erëra nga veriu. Temperatura mesatare vjetore është 10.4°C (janar -1.0°C, gusht rreth 20°C). Reshjet janë më të mëdha në pjesën jugore, ndërsa ato mesatare sillen rreth 600 mm. Diellosja sillet rreth 2,150 orë/vit. Tokat kryesore janë smonica, tokat aluviale, moçalore, pseudoglej etj. Janë tejet të plleshme kur ujiten dhe mundësojnë zhvillimin e bujqësisë intensive.

Në Rrafshin e Kosovës paraqiten sasi të mëdha të linjtit, argjilave, ndërsa në pjesët anësore kodrinore të tij ka rezerva të mëdha të plumb-zinkut dhe magnezitit. Karakterizohet me


dendësi të madhe të popullsisë. Vendbanimet kryesore janë Mitrovica, Prishtina, Ferizaj, si dhe një numër i vendbanimeve urbane dhe rurale. (Vahdet Pruthi)

RRAHMANI Agron (1971-1998). Veprimtar politik dhe ushtarak i Lëvizjes Kombëtare për Çlirimin e Kosovës (LKÇK) dhe i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Lindi në fshatin Ballofc të komunës së Podujevës. Pasi kreu shkollën e mesme në Podujevë, u regjistrua në Fakultetin Teknik të Universitetit të Prishtinës. Bashkë me një grup shokësh formuan Lëvizjen Kombëtare për Çlirimin e Kosovës (LKÇK), e cila kishte synim luftën e armatosur për çlirimin e Kosovës. Në vitin 1993, pas një vale të arrestimeve të aktivistëve të LKÇK-së, A. Rrahmani kaloi në ilegalitet. Aktivitetin e përqendroi në përgatitjen, botimin dhe shpërndarjen e fletushkës “Çlirimi”, organ i LKÇK-së. Më pas u emërua komandant i njësitit të parë gueril, të formuar nga aktivistët e LKÇK-së. Në fillim të vitit 1998 ky njësit u bashkua me strukturat e njërive të UÇK-së. Më 12 maj 1998 në Lagjen e Muhaxhirëve në Prishtinë, A. Rrahmani, bashkë me Fatmir Humollin, ranë në pritë të forcave policore serbe. Në këtë përballje u vra A. Rrahmani, ndërsa Fatmir Humolli i plagosur arriti të tërhiqet. Në vitin 2013 u dekorua me Urdhrin “Heró i Kosovës”. (Ismet Cakiqi)

RRAHMANI Kujtim (1968-). Shkrimtar, studiues i letërsisë. Lindi në Podujevë, ku kreu shkollimin fillor dhe të mesëm. Ndoqi studimet në Universitetin e Prishtinës, ku mori gradën doktor i letërsisë me temën për prozën e Koliqit, Kutelit dhe Pashkut. Deri më tani ka botuar disa libra me studime, si: “Gramatika e fshehtë e motiveve” (1998), “Intertekstualiteti dhe Oraliteti: Koliqi, Kuteli, Pashku” (2002), si dhe librin eseistik “Antropoetikë - një confession” (2008), “Letra dhe ideologji” (2012). Ka botuar dhe dy romane: “Secili citonte Biblën” (1994), “Vrimë e zezë, njolla blu dhe të kuqe” (1998), “Taksa e gjumit”, tregime (2016). Me dy romanet funksionalizoi intertekstualen dhe elementet postmoderne të teorizuara në dy veprat e para kritike. Me librin “Antropoetika”, një himn ky për poezinë, bën një sprovë personale dhe filozofike, duke i lidhur në një tekst-lexues, autor-lexues. Ka ndjekur kurse dhe studime postdoktorale në

disa universitete amerikane dhe europiane. Ka fituar çmimin e parë për roman nga Shoqata e Shkrimtarëve të Kosovës më 1994. Punon në Institutin Albanologjik të Prishtinës. (Zejnullah Rrahmani)

RRAHMANI Nazmi (1941-). Romancier, botues. Lindi në Ballofc të Podujevës. Kreu edukimin fillor e të mesëm në Podujevë dhe Prishtinë, ndërsa studimet e larta për gjuhë dhe



NAZMI RRAHMANI

letërsi shqipe në Universitetin e Prishtinës. Më 1960 nisi punën si gazetar e pastaj si redaktor në Radio Prishtinë, e më vonë redaktor në revistën letrare “Jeta e re”. Për shumë vjet ishte redaktor në Redaksinë e Botimeve të “Rilindjes”, e për një kohë edhe udhëheqës i saj. Në letërsi hapin e parë të rëndësishëm e bëri me romanin “Malësorja” (1965), e që ishte ndër romanet e para të prozës shqipe në Kosovë. Në këtë veprë me temë sociale nga fshati, autori trajtoi me realizëm fatin e femrës shqiptare në një shoqëri dhe familje jo të zhvilluar. Meqë botimi i veprës u lidh me kohën e aspiratave për një zhvillim të përgjithshëm iluminist dhe emancipues të Kosovës, romani i tij “Malësorja” u bë shumë i dashur, u ribotua disa herë dhe hyri në leximet e obliguara të nxënësve dhe studentëve. N. Rrahmani botoi edhe këto romane: “Tymi i votrës së fikun” (1969), “Toka e përgjakur” I, II (1973), “Pas vdekjes” (1975) dhe “Rruga e shtëpisë sime” (1978). Edhe në këto vepra jepet një pasqyrë e gjerë realiste e jetës rurale të Kosovës në kushtet e rënda të sundimit të regjimeve të huaja, si dhe normave zakonore e bindjeve të prapambetura kryesisht në gjysmën e parë të shek. XX. Edhe pse në rrethana të rënda sociale, në të cilat formohen dhe veprojnë, personazhet e romaneve të N. Rrahmanit ruajnë virtyte të larta njerëzore e kombëtare. Është marrë edhe me përkthime, duke sjellë në shqip vepra të njohura të letërsisë botërore dhe jugosllave. Gjatë tri dekadave të fundit N. Rrahmani nuk botoi vepra të reja. Është drejtues i Shtëpisë Botuese “Faik Konica” në Prishtinë. (Femi Cakolli)

RRAHMANI Zejnullah (1952-). Romancier, tregimtar dhe studiues i letërsisë, akademik. Lindi në Ballofc, Podujevë, ku kreu gjimnazin.



ZEJNULLAH RRAHMANI

Mbaroi studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin Filozofik të Prishtinës, ku më pas kreu studimet pasuniversitare dhe doktoratën në fushën e teorisë së letërsisë. Në fillim punoi si gazetar në revistën “Fjala”. Nga viti 1977 punon në Fakultetin e Filologjisë së Universitetit të Prishtinës. Në sistemin paralel të arsimit (1990-1999) ishte dekan i Fakultetit të Filologjisë. Veprat: “Zanoret e humbura” (1974), “Udhëtimi i një pikë-ujj” (1976), “E bukura e dheut” (1977), “Sheshi i unazës” (1978), “Nga teoria e letërsisë shqipe” (1986) “Udhëtimi arbdhetar” (1992), “Mjeshtri i vetmisë” (1995), “Romani për Kosovën” (2000), “Jusufi” (2000), “Teoritë letrare klasike” (2001), “Si të shkruhet disertacioni” (2001), “Arti i poezisë” (2001), “Malësorja e Nazmi Rrahmanit ose arti i interpretimit” (2001), “Letërsia e mesjetës” (2002), “Ligjërrata mbi artin e Renesancës” (2004), “Letërsia e Lindjes” (2005), “99 rruzaret prej smaragdi” (2006), “Kryevepra poezie” (2007), “Letërsi klasike greke” (2008), “Iluminacion” (2008), “Tregimet e Ballofcit” (2008), “Lypësi dhe Sophia” (2011), “Pesë vakte” (2013). Z. Rrahmani ligjëron teorinë e letërsisë dhe teoritë letrare për shumë vjet me radhë. Si shkrimtar u shfaq në fillim të viteve shtatëdhjetë me romanin “Zanoret e humbura”, ku shpалosi poetikën e re narrative dhe begatinë e madhe të shprehjes gjuhësore e stilistike. Temës së lirisë shqiptare e njerëzore dhe kërkimit të saj do t’i kthehet edhe në dy romanet tjera, “Sheshi i Unazës” dhe “Udhëtimi arbdhetar”. Vepra e tij shpreh kërkesën e madhe në hulumtimin dhe ndërtimin modern të strukturës së romanit dhe përdorimin e gjuhës shqipe, të fjalës dhe frazës së saj, shumë përtej strukturës klasike të romanit dhe mundësive të kufizuara të standardit letrar. Fusha tregimtare, e filluar me “Mjeshtri i vetmisë” (1995), shënon linjën e hulumtimit të brendshëm, psikologjik e shpirtëror të individit, që plotësohet më vonë me qarkun familjar të komunitetit dhe të trashëgimisë kulturore të tyre në “Tregimet e Ballofcit” (2008). Në prozën e shkruar pas vitit 1999, Z. Rrahmani tejkaloi kufijtë e zhanrit të veçantë dhe shpалos një botë njerëzore të përgjithshme, të pleksur

njëkohësisht si fizike, partikulare, psikologjike e shpirtërore, njerëzore e hyjnore, në të cilën sendet, veprimet, përjetimet e dijet ndërtojnë një estetikë të re, flasin artistikisht me mjeshtri për njeriun, njerëzimin dhe njerëzoren universale. (Ali Aliu)

RRAPI Gjergj (1938- 2002). Sociolog, profesor universitar. Lindi në Stupë të Klinës, shkollën fillore dhe të mesme i mbaroi në Pejë, studimet për sociologji i mbaroi në Universitetin e Beogradit. Doktoroi në Prishtinë me temën “Martesa e shqiptarëve të Kosovës” (1986). Në katedrën filozofi-sociologji të Fakultetit Filozofik ligjëroi lëndët sociologji e përgjithshme dhe metodologjia e sociologjisë. Ligjëroi sociologjinë edhe në Fakultetin Ekonomik të UP-së. Fusha kryesore e hulumtimeve të tij ka qenë familja dhe ndryshimet strukturale në familjen shqiptare në Kosovë. Në vitin 1983 u zgjodh drejtor i Institutit të Filozofisë dhe të Sociologjisë. Kontribuoi në realizimin e disa hulumtimeve empirike. Është autor i tekstit universitar “Sociologjia”, pastaj i veprës “Familja e madhe bashkëkohore shqiptare”, i botuar në gjuhën serbe (Institut i Hulumtimeve Sociale, Beograd 1995) dhe në gjuhën gjermane (Böhlau, Austri 2003). Ishte bashkëthemelues i Partisë Liberale të Kosovës e një kohë edhe kryetar i saj. (Shemsi Krasniqi)

RREGULLATORËT. Institucione të pavarura, të cilët rregullojnë sfera të caktuara me rëndësi për produktet dhe shërbimet që zakonisht nuk mund të rregullohet nëpërmjet tregut qoftë për shkak të monopoleve natyrore ose të specifikave të tjera. Ekziston një spektër i gjerë i rregullatorëve të pavarur, të cilët kanë për detyrë të përcaktojnë çmimet për fusha të caktuara, të rregullojnë konkurrencën dhe të përcaktojnë standardet e cilësisë për produkte dhe shërbimet e caktuara dhe të mbrojnë konsumatorët. Rregullatorët formohen me ligjet që rregullojnë funksionimin dhe zhvillimin e fushave të caktuara, siç është energjia, telekomunikimet, mediet elektronike dhe shtypi, arsimit i lartë, bankat e financat etj. Rregullatorët formohen nga Kuvendi i Kosovës, si agjenci të pavarura. Kuvendi gjithashtu emëron bordet e tyre dhe ato i raportojnë atij në baza vjetore. (Muhamet Mustafa)

RRËFIMTARËT. Krijues dhe bartës të krijimtarisë folklorike, të cilët përmes rrëfimit përcjellin mesazhet përkatëse të një audiencë të caktuar. Ata ruajnë dhe bartin krijimtarinë letrare gojore, të trashëguar brez pas brezi. Rrëfimtaret janë njohës të folklorit, të traditës dhe të etnopsikologjisë së mjedisit, ku e formësojnë dhe transmetojnë rrëfimin. Ata njohin ligjësitë e formësimit dhe të transmetimit të rrëfimeve folklorike, njohin frymën e kësaj krijimtarie, si dhe shijen dhe preferencat e mjedisit ku rrëfohen, prandaj i zgjedhin temat e preferuara të mjedisit, të cilat i formësojnë sipas modeleve të krijimeve përkatëse. Tradita jonë folklorike njihet rrëfimtari të shumtë të përrallës, të anekdotës (meselesë), të pleqnive, të kallëzimeve popullore etj. Rrëfimtari kreativ luan rol të rëndësishëm në pasurimin e përmbajtjeve dhe në ngritjen e nivelit artistik të krijimtarisë gojore, me anë të zgjedhjes së metaforave dhe të mjeteve të tjera stilistike. (Myzafer Mustafa)

RRËQEBULLI. (*Lynx lynx* L.) Ka përhapje në Euroazi dhe në Amerikë, bën pjesë në familjen e maceve (Felidae) dhe quhet ndryshe “Tigri i Europës”. Ka një gjatësi trupore 125 cm dhe



lartësi deri 70 cm, peshon deri në 40 kg. Për shkak të tipareve të veçanta gjenetike në Ballkan klasifikohet si nënloj më vete dhe quhet rrëqebulli i Ballkanit (*Lynx lynx ssp balcanicus*). Jeton në zonat e Shqipërisë, Maqedonisë, Kosovës dhe Malit të Zi. Në Kosovë ka shtrirje

në malet e Sharrit, Koritnikut dhe në Bjeshkët e Nemuna. Është aktiv kryesisht natën. Shqisa kryesore e rrëqebullit është shikimi, që është 6 herë më i fortë se e njeriut, por kanë dëgjim shumë të mirë. Ushqehet me një gamë të gjerë të kafshëve si kaprolli, dhia e egër, dhelpra, kafshë shtëpiake (dele), ketra, minj dhe shpezë të ndryshëm të pyllit. Është kafshë tipike vetmitare dhe takohet me rrëqebuj të tjerë vetëm në sezonin e çiftimit që fillon në muajin shkurt-mars dhe femra, pas rreth 70 ditësh, lind 1-4 këlysh një herë në vit. Jeton deri 17 vjet. Rrëqebulli është nga llojet më të rrezikuara nga të gjithë gjitarët e Ballkanit. Ekspertët vlerësojnë se numri i individëve të rrëqebullit në Ballkan është rreth 100. Me akte zyrtare të Kosovës është e ndaluar gjuetia e rrëqebullit. (Ibrahim Muja)

RRËSHQITJET. Janë zhvendosje të ngadalshme të masës shkëmbore, pa rrokullisje, përgjatë shpatit, nën ndikimin e gravitetit. Faktorët që ndikojnë në prishjen e qëndrueshmërisë së shpateve janë reshjet atmosferike, tërmetet, ndërtimi gjeologjik i terrenit, pjerrtësia e relievit, bimësia dhe veprimtaria e njeriut. Rrëshqitjet mund të jenë sipërfaqësore ose të thella disa metra. Rrëshqitjet shkaktojnë dëmtimin e shtëpive të banimit, shkatërrimin e tokave bujqësore, të pyjeve, të veprave hidroteknike, të rrugëve etj. Në Kosovë terrenet e pjerrëta e të ndërtuara prej flishit, sedimenteve ranore-argjilore të pliocenit janë të përshtatshme për paraqitjen e rrëshqitjeve. Një rrëshqitje e madhe ka ndodhur para disa vitesh në rajonin e Brodit (Dragash). Ekzistojnë edhe disa rrëshqitje më të vogla në rajonin e Llapit, Kaçanikut, Suharekës etj. Në Prishtinë ka ndodhur një rrëshqitje në Arbëri (Dragodan), e cila e dëmtoi rrugën e asfaltuar dhe rrezikoi kompleksin banesor. (Shpejtim Bulliqi)

RRITJA EKONOMIKE. Është përqindja e rritjes reale e produktit të brendshëm bruto (PBB), për një periudhë të caktuar, zakonisht brenda një viti kalendarik, në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Rritja reale ekonomike dallon nga rritja nominale, ngase nuk merr në konsiderim ndikimet e inflacionit në vlerën e produktit të brendshëm bruto. Kështu, nëse rritja nominale ekonomike është 5%, kurse inflacioni është 2%, i bie se rritja ekonomike reale është 3%. Rritja ekonomike

krijon kushte për të ngritur cilësinë e jetesës së qytetarëve të një vendi, pasi krijon më shumë hapësirë për konsum, investime dhe shpenzime qeveritare. Varësisht nga niveli i produktit të brendshëm për një banor, Banka Botërore bën një klasifikim të ekonomive botërore në: ekonomi me të ardhura të ulëta, ku produkti i brendshëm për një banor është më i vogël se 765 \$; ekonomi me të ardhura të mesme të ulëta, ku produkti i brendshëm për një banor është 765-3,200 \$; ekonomi me të ardhura të mesme të larta 3,035-9,385 \$ dhe ekonomitë me të ardhura të larta mbi 9,385 \$. Ky tregues merret edhe për krahasimin e nivelit të zhvillimit ekonomik në rrafshin ndërkombëtar, edhe pse ka dilema dhe vështirësi që kanë të bëjnë me shndërrimin e vlerave dhe çmimeve të produkteve e shërbimeve nga një valutë në tjetrën si dhe të fuqisë blerëse të një sasive parash që dallon prej një vendi në vendin tjetër. Rritja ekonomike në Kosovë që nga fundi i Luftës së Dytë Botërore ka pasur ritme të ndryshme. Karakteristikë është rritja shumë e vogël në periudhën 1945-1955 (5.7%), rritja më dinamike 1960-1975 (6-7.5%), një ngadalësim i ritmit në periudhën 1976-1990 (3.6-1.56%), rritje negative ekonomike gjatë viteve 1991-1999 (-8.7%), vite që karakterizohen me situatën e pushtimit nga Serbia; si dhe në fund, një rritje ekonomike me oscilime që nga viti 2000 e tutje (nga 10-16% në vitin e parë të pasluftës, në -3% në vitet 2002-2005, 3-5% në vitet 2006-2009 dhe 2-4% në vitet 2010-2014). Në përgjithësi, rritja ekonomike në Kosovë ka qenë e pamjaftueshme për të rritur standardin e jetesës dhe për të gjeneruar vende pune në harmoni me rritjen e popullsisë dhe rritjen e kërkesës për punë. Kjo ka bërë që niveli i zhvillimit të Kosovës në krahasim me vendet e tjera europiane, përkatësisht me mesataren europiane, të mbetet i ulët dhe që ky hendek të mos zvogëlohet. Tani Kosova është në nivel të 10% të produktit të brendshëm bruto për një banor të mesatares europiane. Konsiderohet se për të filluar procesin e zvogëlimit të këtyre diferencave, Kosovës i duhet një normë afatgjate e rritjes ekonomike prej 7% e më shumë. (Muhamet Mustafa).

RRJETI BALLKANIK PËR GAZETARI HULUMTUESE (BIRN). Organizatë mediale për gazetari hulumtuese dhe projekte televizive online, e themeluar në vitin 2005. Themelues

të degës së kësaj organizate për Kosovën (BIRN Kosova) janë gazetarja Jeta Xharra dhe regjisorin Irfan Ispahiu. BIRN-i bashkëprodhon emisionet “Jeta në Kosovë” dhe “Drejtësia në Kosovë”. Nga viti 2008, BIRN-i publikon gazetën e vetme në gjuhë angleze për audiencën e huaj në Kosovë, “Prishtina Insight”, ndërsa nga viti 2011 edhe publikimin online “Jeta në Kosovë”, e specializuar për hulumtime dhe analiza. Në vitin 2012, në partneritet me “Internews Kosova” krijoi platformën e pavarur për raportimin e korrupsionit dhe parregullsive në shërbimet publike “Kallxo.com”. BIRN-i bën hulumtime të ndryshme, analiza financiare, monitorim të shpenzimeve të parasë publike, qasjen në dokumente publike, monitorimin e zgjedhjeve etj. Rezultat i punës së tyre janë raportet vjetore analitike të prokurimit, monitorimet vjetore të testit të maturës dhe monitorimi i zgjedhjeve lokale dhe parlamentare në Kosovë. Gjatë dhjetë vjetëve të punës, ekipi i BIRN-it ka trajnuar mbi 1,000 gazetarë, aktivistë të shoqërisë civile, zyrtarë të institucioneve publike dhe grupe të qytetarëve. BIRN-i është pjesë e Rrjetit Rajonal për Gazetari Hulumtuese, i pranishëm në tërë Ballkanin, në të cilin janë të përfshirë rreth 400 gazetarë, hulumtues, redaktorë e profesionistë të medias në Shqipëri, Maqedoni, Serbi, Bosnjë dhe Hercegovinë, Rumani, si dhe një numër korrespondentësh nga vendet e tjera. (Ibrahim Berisha)

RRJETI RRUGOR. Sistem i rrugëve publike, që nënkupton sipërfaqen me rëndësi të përgjithshme për komunikacion rrugor, të cilat shfrytëzohet nga pjesëmarrësit në komunikacion sipas kushteve të shpallura nga organi kompetent. Totali i rrjetit të rrugëve në Kosovë (6,973 km) përfshin kategoritë: autostrada që lidh Kosovën me Shqipërinë (78 km); rrugët nacionale (629 km), të cilat lidhin qendrat, përkatësisht qytetet kryesore ndër vete dhe me vendet e tjera, të cilat janë të asfaltuara 99,5%; rrugët rajonale (1,305 km), që lidhin qendrat komunale brenda Kosovës, të asfaltuara 93,3%; rrugët lokale (4,355), që lidhin lokalitetet brenda një komune. Në kategorinë e rrugëve nacionale përfshihen rrugët që lidhin Prishtinën me Mitrovicën, Prizrenin, Pejën, Gjakovën, Ferizajn dhe Gjilanin, të cilat vazhdojnë të lidhen me Shqipërinë, Serbinë, Maqedoninë dhe Malin

e Zi. Rrjeti i rrugëve moderne në Kosovë ka filluar të zhvillohet kah mesi i viteve 60, ka stagnuar dukshëm në periudhën 1990-2006, ndërsa më pas u bënë investime intensive në të gjitha kategoritë e rrugëve. Tani Kosova është relativisht mirë e lidhur me rrjetin rrugor midis lokaliteteve dhe qendrave, por mbetet mjaft e izoluara sa i përket korridoreve ndërkombëtare. Kjo situatë do të përmirësohet me përfundimin e Rrugës së Kombit nga Prishtina deri në Merdar, ku do të mundësohet lidhja me korridoret europiane në drejtim të Europës Qendrore dhe Perëndimore, e gjithashtu edhe me përfundimin e investimeve në autostradën Prishtinë-Shkup, e cila mundëson lidhjen me vendet e Ballkanit Juglindor, me Turqinë dhe me korridoret e rrugëve në lindje. Rrjeti i rrugëve ka rëndësi esenciale për zhvillimin ekonomik dhe social edhe për Kosovën, sepse në 7 qendrat kryesore rajonale të Kosovës, në perimetrin e tyre prej 20 km, graviton 95% e popullsisë së Kosovës, ndaj një rrjeti i mirë i rrugëve zgjidh shumë probleme të transportit dhe të zhvillimit ekonomik. (Ymer Havolli)

RRUGËT MESJETARE. Nga periudha mesjetare është ruajtur tërësia e rrugëve që lidhnin qytetet dhe krahinat shqiptare ndër veti dhe me pjesët e tjera të Ballkanit. Pjesa më e madhe e këtyre rrugëve janë shfrytëzuar edhe gjatë antikitetit. Në trevat jugore shqiptare në drejtimin perëndim-lindje ka pasur disa rrugë: Bregdet-Berat-Fushë e Korçës-Kostur-Manastir, Vlorë-Vjosë-Janinë; në viset qendrore në drejtimin perëndim-lindje: Bregdet-Bulqizë-Dibër-Pollg-Shkup; Durrës-Ohër-Manastir-Selanik-Konstandinopojë; në viset veriore në drejtimin perëndim-lindje: Raguzë (Dubrovnik)-Cetinë-Pazari i Ri-Zveçan (Mitrovicë)-Nish, Bregdet-Breskovë (Plavë?)-Pejë-Fushë e Dardanisë-Kaçanik-Shkup; Bregdet-Shkodër-Dardania Perëndimore-Fushë e Dardanisë-Nish (si dhe degëzimet: Prizren-Tetovë dhe Prizren-Fushë e Dardanisë-Kaçanik-Shkup; Kotorr-Podgoricë-Plavë-Pejë-pranë malit Golesh-Fushë e Dardanisë (si dhe degëzimet: Pejë-Deçan-Prizren, Pejë-Istog-Trepçë, Pejë-Drenicë-Fushë e Dardanisë); Bregdet-Prizren-Qafë e Dulës-Lipjan-Shkup (si dhe degëzimet: Lipjan-Janjevë-Novobërdë-Zhupë e Moravë-Vranjë-Sofje dhe Prizren-Tetovë. Në drejtimin veri-jug, njëra rrugë ka kaluar pranë viseve bregdetare shqiptare, kurse tjetra

ka ndjekur itinerarin: Kroaci-Bosnjë-Banjskë (te Mitrovica)-Zveçan-Fushë e Dardanisë, prej nga janë lidhur viset shqiptare në vijën Shkup-Manastir-Kostur-Janinë (si dhe degëzimi: Shkup-Pollog-Kërçovë (ose Dibër)-Ohër. Disa nga rrugët e tjera ishin: Nish-Prokuple-Kurshumli-Lugina e Llapit-Prishtinë-Lipjan-Prizren-Lezhë; Beograd-Rudnik-lugina e Ibrit-Zveçan-Vuçitërnë-Prishtinë-Lipjan-Kaçanik-Shkup. Në trevat shqiptare dhe nëpër Fushën e Dardanisë (Kosovës) gjatë mesjetës ka pasur edhe rrugë të tjera dytësore. (Qerim Dalipi)

RRUGËT NË DARDANI. Territori dardan përshkohej nga rrugë të rëndësishme transballkanike gjatë antikitetit. Ndërtimi i tyre u kushtëzua nga faktorët gjeofizikë dhe pozita gjeografike. Duket se në parahistori përdorehin rrugët natyrore, për t'u ndërtuar rrjeti i rrugëve gjatë periudhës romake. Këto rrugë u ndërtuan për nevoja ushtarake dhe ekonomike. Koha kur nisën ndërtimet është vështirë të saktësohet, por duket se këto nisën në kohën e perandorit Oktavian Augusti dhe përfunduan gjatë sundimit të perandorëve Trajan dhe Hadrian. Ndërtimi i një rrjeti të tërë rrugësh si dhe mirëmbajtja e vazhdueshme e tij dëshmon rëndësinë strategjike dhe ekonomike që territoret dardane paraqisnin për interesat e Perandorisë Romake. Itineraret romake sjellin pak të dhëna mbi këto rrugë, pos "Tabula Peutingeriana", i cili është burimi më i plotë për rrugët në Dardani. Rruga kryesor që përshkonte Dardaninë ishte rruga Lissus-Naissus. Rrugë tjetër e rëndësishme ishte ajo që vinte nga perëndimi (Dalmacia) dhe kalonte përmes Rrafshit të Kosovës nëpër territorin e Ulpianës dhe të Shkupit, duke lidhur brigjet veriore të Adriatikut me provincat jugore të Ballkanit. Kishte edhe një varg rrugësh të tjera vicinale, që lidhnin qendrat e ndryshme urbane ndërmjet tyre si dhe zonat e eksploatimit të minierave. Përgjatë këtyre rrugëve janë vendosur edhe një varg pikash kontrollimi (stationes vectigales, stationes beneficarii), si dhe i bujtinave me hapësirë për shkëmbimin e kuajve. (Arben Hajdari)

RRUSTEMAJ Halil (1954-). Gazetar. Lindi në Skivjan, komuna e Gjakovës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, shkollën normale në Gjakovë, ndërsa studimet për gazetari në Fakultetin Juridik dhe për gjuhë dhe letërsi

angleze në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Prishtinës (1980). Nga viti 1983 ishte gazetar-spiker në Radio-Gjakovë, më pas gazetar në Televizionin e Prishtinës. Në vitin 1993 emigroi në Gjermani, prej nga vazhdoi të bashkëpunojë me Radiotelevizionin Shqiptar dhe me gazetat "Bujku", "Bota sot", "Fokus" etj. Në vitin 1999 punoi gazetar-redaktor dhe moderator në redaksinë në gjuhën shqipe të Radios "Deutsche Welle" në Këln dhe Bon, ku drejtoi emisionin "Ura radiofonike", deri në vitin 2004. Nga ai vit është producent dhe reporter i lirë. Realizoi një sërë emisionesh dokumentare dhe televizive që u transmetuan në televizione të ndryshme shqiptare, në Kosovë dhe në Shqipëri. Jeton në Bon të Gjermanisë. (Bajrush Morina)

RRUSTEMI Sabit (1959-). Shkrimtar. Lindi në Terizaj, Gjiilan. Kreu shkollimin fillor në Zhegër, të mesmen në Gjiilan, ndërsa studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Prishtinë. Shkruan poezi dhe prozë për të rritur dhe për fëmijë. Shkrime letrare ka botuar nëpër të gjitha gazetat dhe revistat në gjuhën shqipe. Në vitin 1977 botoi poezinë e parë. Në vitin 1981 u burgos për shkak të botimit të tregimit "Nën maskën e mysafirëve" dhe u dënua me katër vjet heqje lirie. Në vitin 1990 botoi përmbledhjen e parë të poezive, "Ku i la lisat era", libër i dorëzuar për botim që në vitin 1981. Vepra të tjera të botuara: "Besoj në një diell" (1992), "Pika e zezë" (1993), "Jetëshkrimi i Sylë Kopernicës" (prozë dokumentare, 1994), "Natyre me vaj" (1994), "Variacione për lirinë" (1997), "Maska e mysafirëve" (1997), "Ëndrra që puthet" (2001), "Paqja e brishtë" (2007), "Shiu i buzëve tua" (2009), "Nën qerpikun tënd" (2009). Poezitë e tij janë përkthyer dhe janë përfshirë në antologji. Merret edhe me aktivitet politik. Në vitet 2001-2004 ishte deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Është botues dhe kryetar i Art-Clubit "Beqir Musliu" në Gjiilan (Nazmi Rrahmani).

RRUSTEMI-NEZIRAJ Blerta (1984-). Regjisore. Lindi në Prishtinë, ku kreu arsimin fillor dhe të mesëm. Mbaroi studimet për regji teatri në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. Studoi gjithashtu për psikologji në Universitetin Lumière Lyon 2 në Francë. Në Qendrën Multimedia bëri regjinë e shfaqjeve: "Yue Madeleine Yue" (2012), "Fluturimi mbi Teatrin e Kosovës" (2012), "Shembja e Kullës së

Ajfelit” (2013) dhe “Lufta në kohën e dashurisë” (2015). Përveç në skenën teatrore vendore, shfaqjet e saj janë paraqitur nëpër teatro dhe festivale të ndryshme ndërkombëtare (Gjermani, Austri, Kroaci, Serbi, Slloveni, Shqipëri, Maqedoni etj.). (Erson Zymberi)

S

SAADIZMI. Është rrugë mistike islame e themeluar në Damask nga Saduddin Muhammed el-Xhibavi (vdiq në vitin 1300). Gjatë jetës së themeluesit dhe pas tij u përhap në Siri dhe Egjipt, ndërsa në Perandorinë Osmane depërtoi në fillim të s'hek. XVIII nëpërmjet themeluesit të degës Vefaie, Sheh Ebu'l-Vefa Shamiut dhe themeluesit të degës Selamie të këtij tarikati, Sejid Abduselam Shejbaniut (vdiq në vitin 1752). Në viset shqiptare tarikati saadi u përhap nëpërmjet Sulejman efendi Shkodranit, i cili lindi në Shkodër dhe në Stamboll hyri në këtë tarikat, duke marrë dorë prej vetë shehut Ibrahim Ebu'l-Vefa, themelues i degës Vefaie të tarikatis saadi. Pas kthimit nga Stambolli, Sulejman Axhizi Baba (vdiq më 1728) u vendos në Gjakovë dhe aty, në fillim të shek. XVIII themeloi një teqe. Pas sheh Danjallit, në Teqenë e Madhe në Gjakovë në post janë ulur edhe shumë shehlerë të tjerë, të cilët kanë luajtur rol të rëndësishëm në jetën fetare dhe kulturore të Gjakovës. Përveç Teqesë së Madhe në Gjakovë, saaditë kanë vepruar edhe në Teqenë e Zejnelabidinit dhe të sheh Eminut. Sheh Sulejmani në Prizren, në Marash, ndërtoi një teqe të re. Teqe saadie në Kosovë ka pasur edhe në Gjilan, në Marec të Novobërdës, në Nesalc të Bujanocit etj. (Metin Izeti)

SABEDINI Musa (1971-). Gazetar. Lindi në fshatin Stublinë të komunës së Gjilanit, ku kreu shkollën fillore, kurse të mesmen në Gjilan. Përfundoi studimet për gazetari në Universitetin e Prishtinës. Në vitin 1993 nis punën në gazetën studentore "Bota e re", ndërsa në periudhën 1994-1997 ishte kryeredaktor i saj. Në vitet 1990-91 botoi shkrime në gazetën "Bujku", "Shkëndija", "Kosovarja" etj. Gjatë viteve 1997-1998 ishte korrespondent nga Gjilani në gazetën "Kosova sot". Pas luftës

vazhdoi me gazetari në të përditshmet "Epoka e re", "Kosova Live", "Lajm" etj. U zgjodh katër herë korrespondent i vitit në Kosovë, me shkrime dhe raporte për jetën politike, arsimore, kulturore dhe sportive nga komuna e Gjilanit. Aktualisht udhëheq agjencinë rajonale të lajmeve "Rajonipress". (Veli Bytyçi)

SADIKAJ Beqir (1954-). Sociolog, profesor universiteti. Lindi në fshatin Studenicë, komuna e Istogut. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, studimet për filozofi-sociologji në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës (UP). Kreu studimet pasuniversitare në Zagreb, ndërsa u doktorua në Prishtinë. Punën e mësimdhënësit universitar i nisi në Fakultetin Juridik dhe më vonë mori angazhime në fakultetet e tjera të UP-së. Ka mbajtur mësim në Universitetin e Tetovës dhe në Universitetin e Europës Juglindore në Tetovë. Ka marrë pjesë me kumtesa në disa konferenca shkencore brenda dhe jashtë vendit dhe është autor i punimeve të botuara në revista të ndryshme. Është autor i monografisë "Fshatarët punëtorë në Kosovë deri në vitin 1990" (2004) dhe i tekstit universitar "Sociologjia e së drejtës" (2010). (Mexhit Shaqiri)

SADIKU Bedri (1953-). Shahist. Mban kategorinë e mjeshtrit ndërkombëtar të shahut. Mësues i tij i parë ishte Sabedin Sabedinaj. Sadiku për herë të parë mori pjesë në gara në Kampionatin e Kosovës në vitin 1968, ku u shpall edhe kampion, si anëtar i KSH "Prishtina". Me përfaqësuesen e të rinjve të ish-Jugosllavisë u paraqit në katër ndeshje kundër Gjermanisë, Holandës, Hungarisë dhe Anglisë. Mori pjesë në shumë turne ndërkombëtare si dhe kampionate europiane. Ndër sukseset më të dalluara të tij janë: vendi i parë në

Karlovi Vari të Çekisë (1986), vendi i parë në Groningen të Holandës (1987), vendi i parë në Antwerpen të Belgjikës (1988) etj. Titullin e mjeshtrit ndërkombëtar e fitoi në Prishtinë në vitin 1982, të cilin e vërtetoi edhe tri herë të tjera në Athinë të Greqisë, në Basti të Francës dhe në Gironë të Spanjës. (Bekim Aliu)

SADIKU Milote (1974-). Gjuhëtare, gjermaniste. Lindi në Gjilan, ku kreu shkollimin fillor dhe të mesëm, ndërsa më 1997 mbaroi studimet për gjuhë dhe letërsi gjermane në Universitetin e Prishtinës (UP). Vitin e katërt të studimeve (1995-1996) e mbaroi në Universitetin e Jenës (Gjermani). Në vitin 2012 mbrojti në UP tezën e disertacionit: “Studim kontrastiv i frazeologjizmave me emërtime të kafshëve të gjuhës gjermane dhe të gjuhës shqipe”. Nga viti 1997 punon në departamentin e gjuhës dhe të letërsisë gjermane në UP, ku ligjëron disa lëndë nga fusha e gjuhës gjermane. Gjatë viteve 2011-2013 ishte koordinatore e projektit të Tempusit “Kompetencat në UP”, ndërsa gjatë viteve 2013-2016 koordinatore për zhvillim akademik në Fakultetin e Filologjisë. Që nga viti 2016 është anëtare e Kryesisë së Shoqatës së Gjermanistëve të Evropës Juglindore (SOEGV). Ka marrë pjesë në konferenca shkencore brenda dhe jashtë vendit, si dhe ka botuar punime shkencore nga fusha e gjuhësisë kontrastive, frazeologjia dhe fjalëformimi. (Bardh Rugova)

SADIKU Muamer (1963-). Skulptor. Lindi në Çegran të Gostivarit. Kreu shkollimin bazë në Gostivar, ndërsa studimet për skulpturë në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Tetovës. Është pedagog në Fakultetin e Arteve të Universitetit Shtetëror të Tetovës. Mori pjesë në disa ekspozita kolektive, vendore dhe ndërkombëtare. Në vitin 2008 realizoi shtatoren e Komandant Tigris. Është autor i shtatores së Josif Bagerit. Kreu funksione të ndryshme në disa institucione kulturore e artistike në Maqedoni. Është anëtar i Shoqatës “Draudakum” të Gostivarit dhe i Shoqatës së Artistëve Figurativë të Maqedonisë. (Jëldeze Asani)

SADIKU Nazmi (1943-). Pikturor. Lindi në Pejë. Kreu shkollimin fillor e të mesëm në Pejë. U diplomua në Akademinë Mbretërore të Arteve të Bukura, drejtimi i pikturës, në Bruksel

(1972). Në fillim punoi në Shkollën e Artit në Pejë si mësimdhënës i artit figurativ, pastaj në Radiotelevizionin e Prishtinës si skenograf deri në mbylljen e tij nga regjimi serb më 1990. Realizoi me sukses disa skenografi për drama e filma televizivë. Duhet veçuar skenografitë për filmat artistikë “Pikniku” (1986) dhe “Rojat e mjegullës” (1988). Si anëtar i Shoqatës së Artistëve Figurativë të Kosovës mori pjesë me pikturat e tij në disa manifestime brenda dhe jashtë vendit. Hapi disa ekspozita individuale: në Pejë (1994), Naters të Zvicrës (1998) dhe në Prishtinë (1999, 2000). Në artin e tij pasqyrohet figuracioni me shprehje impresioniste. (Rexhep Goçi)

SADIKU Riza (1949-). Historian. Lindi në fshatin Tuhin të Kërçovës, shkollën fillore e kreu në vendlindje, normalen në Shkup, historinë në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës (1975). Po në Prishtinë kreu studimet pasuniversitare dhe mbrojti tezën e disertacionit të doktoratës (2003). Në vitet 1975-1977 punoi si mësimdhënës dhe më pas, më 1995 punoi në Muzeun e Kosovës, si bashkëpunëtor i lartë profesional. Në vitin 1999 rikthehet në vendin e punës si koordinatör i sektorit të historisë, kurse më vonë këshilltar i lartë profesional. Realizoi një sërë projektesh hulumtuese dhe mori pjesë në organizimin e disa ekspozitave tematike, të muzeve rajonale, të muzeve memoriale dhe të dhomave përkujtimore nga fusha e historisë. Botoi studime e kontribute në gazeta e revista të ndryshme dhe mori pjesë në tubime shkencore brenda dhe jashtë vendit. Është autor i veprave “Hasan Kaleshi, jeta dhe vepra” (1996), “Lidhja Kosovare: 1949-1999” (2006) etj. (Izber Hoti)

SADIKU Rrahim (1954-). Shkrimtar. Lindi në fshatin Komogllavë të Ferizajt. Kreu shkollën fillore në vendlindje, të mesmen në Ferizaj, ndërsa studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe i mbaroi në Universitetin e Prishtinës. Punoi si mësimdhënës në Ferizaj, gazetar në gazetën “Bota e re” në Prishtinë dhe në “Rilindje”. Në vitin 1982 u burgos dhe u dënua me dhjetë vjet burg, si kryeredaktor i gazetës ilegale “Liria”. Pas burgut, më 1991 punoi si mësimdhënës në Shkollën e Mesme të Mjekësisë në Ferizaj. Mori pjesë në luftën e fundit, ku në betejën e Stagovës u plagos. Që nga paslufta punon si kryeredaktor në Radio-Ferizaj. Punimin

e parë letrar e botoi në vitin 1974. Rr. Sadiku shkruan poezi, prozë dhe drama për fëmijë dhe për të rritur. Deri më tash ka botuar një sërë veprash zhanresh të ndryshme. Ka botuar romanet “Ngjarje në kohë të pakohë” (1996), “Kryeatentati” (2000) dhe Shtetthasit” (2011, roman në tre vëllime). Nga dramat e botuara shquhet drama “Shembja” (2006). Po ashtu ka botuar disa monografi kushtuar heronjve dhe dëshmorëve të lirisë. (Hasan Hasani)

SADIKU Zeqir (1942-). Gjuhëtar, profesor universiteti. Lindi në Lipjan. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, të mesmen në Prishtinë. Studioi për gjuhë dhe letërsi ruse në Prishtinë. Studimet pasuniversitare i mbaroi në Beograd, ndërsa tezën e doktoratës e mbrojti në Prishtinë (1977). Në Fakultetin e Filologjisë në Prishtinë punoi nga viti 1972, duke marrë titujt përkatës universitarë, përfshirë edhe titullin e profesorit ordinar të gjuhës ruse (1988). Ishte edhe dekan i Fakultetit të Filologjisë. Botoi tekstin “Fonetika e gjuhës së sotme letrare ruse” (1981) dhe një sërë studimesh dhe artikujsh nga fusha e gramatikës, lidhur me kohët e foljeve, siç janë: “Funksionet semantike të trajtave pluskamperfektore të gjuhës shqipe” (1997), “Funksionet semantike kohore aspektore dhe modale të imperfektit të gjuhës shqipe” (1974), “Rreth opozicionit perfekt-aorist” (1975), “Mbi sinoniminë e kohëve të shkuara në gjuhën shqipe” (1979) etj. Përkthyeu veprën e A. V. Desnickajas “Gjuha shqipe dhe dialektet e saj”. (Bahri Koskoviku)

SADRIAZEMËT ME PREJARDHJE SHQIPTARE. Sadriazemi (veziri i madh) ishte pushtetari më i lartë në hierarkinë e pushtetit administrativ dhe ushtarak osman, i emëruar nga sulltani. Udhëhiqte politikën e brendshme, politikën e jashtme dhe financat. Atij i nënshtroheshin të gjithë vezirët e tjerë, bejlerbejlerët dhe sanxhakbejlerët. Mbante vulën e sulltanit, pa të cilën asnjë akt i lëshuar nga Porta e Lartë nuk kishte vlerë juridike dhe nuk mund të vihej në zbatim. Në pozitën e sadriazemit apo të kryeministrit të Perandorisë Osmane deri në pavarësimin e Shqipërisë nga Porta e Lartë (1912) janë ngritur mbi 40 shqiptarë. I pari nga shqiptarët që ka arritur këtë pozitë është Bajazit Pasha. Ishte personi që luajti rol të veçantë për ardhmërinë e sulltanatit osman pas disfatës së madhe të sulltan Bajazitit

në betejën e Ankarasë (1402) dhe robërimit të tij nga Timurlenku. Ai e nxori nga fushëbeteja princ Mehmetin, në moshë fëmijërore, e mbrojti atë nga pretendentët e tjerë të fronit sulltanor, e vendosi atë në fron më 1413 dhe nga ky vit e deri kur ra në luftë më 1421 kryesoi qeverinë osmane, duke pasur në krah të vëllanë, Hamza Beun. Shqiptari nga Vushtrria, Mehmet Pashë Zognosi, u emërua sadriazem në vitin 1453. Në këtë pozitë ka qëndruar disa muaj dhe pas tij erdhi bashkëkombësi e bashkëvendësi i tij Is'hak Pasha. Në këtë pozitë ai ka qëndruar tri herë, në vitin 1453, më 1469 dhe në vitin 1481. Gedik Ahmed Pasha erdhi në këtë pozitë dy herë, më 1474 dhe 1482. Po në këtë vit u dënua me vdekje. Davud Pasha, i njohur edhe si Ullama Pasha, këtë pozitë e mbajti gjatë periudhës 1482-1497. Ahmed Pashë Dukagjini ishte sadriazem vetëm disa muaj dhe u dënua me vdekje. Po ky fat e ndoqi edhe Junus Pashën (1517). Piri-Mehmet Pasha ishte sadriazem nga viti 1518-1523, ndërsa Ibrahim Pashë Parga nga viti 1523, deri kur u ekzekutua në vitin 1536. Ajas Mehmed Pasha ishte sadriazem nga viti 1536 deri në vitin 1539, Lutfi Pasha nga viti 1539 deri në vitin 1541, Kara Ahmed Pashë Dukagjini nga 1553 deri më 1555, kur edhe u ekzekutua, Semiz Ahmed Pasha nga viti 1579 deri më 1580, kurse Koxha Sinan Pasha e mbajti pesë herë postin e sadriazemit, nga viti 1580, me ndërprerje, deri më 1596, kur edhe vdiq. Ferhat Pasha erdhi në pozitë dy herë (1591-1592 dhe 1595-1595), Hadim Hasan Pasha nga viti 1597 deri më 1598, kur gjithashtu u ekzekutua. Më pas renditen: Hasan Pashë Jemishxhiu (1601-1603, i ekzekutuar), Nasuh Pasha (1611-1614, u ekzekutua), Hysen Pashë Ohri (disa muaj gjatë vitit 1621), Merre Hysein Pashë Peja (1622-1623), Mehmed Pashë Tabanijasi (1632-1637). Mustafa Pashë Kemankeshi (1638-1644, u ekzekutua), Mehmed Pashë Sulltan-zade (1644-1645), Kara Murad Pasha (1649-1650 dhe disa muaj më 1655), Ahmed Pashë Tarhunxhiu (1652-1653), Mehmet Pashë Qypërliu (1656-1661), Fadil Ahmed Pashë Qypërliu (1661-1676), Sijavush Pasha (1687-1688), Fadil Mustafa Pashë Qypërliu (1689-1691), Ali Pashë Arabaxhiu (1691-1692). Hysen Pashë Amxhazade (1697-1702), Hasan Pashë Moreja (1703-1704), Numan Pashë Qypërliu (1710), Haxhi Halil Pashë Elbasani (1716-1717), Ajvaz Mehmed Pasha (1739-1740), Ali Pashë Bijikliu

(1755), Halil Pashë Ajvaz-zade (1769-1770), Mustafa Pashë Bajraktari (1808), Memish Pasha (1808-1809), Mustafa Pashë Pojani (1853-1854 dhe 1857), Halil Rifat Pasha (1895-1901), Mehmed Ferit Pashë Vlora (1903-1908). (Nehat Krasniqi)

SADRIJAJ Xhavit (1966-). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Lindi në Lëbushë të Deçanit. Kreu shkollën e mesme ushtarake në Sarajevë, ndërsa Akademinë Ushtarake në Beograd. Shërbeu në Slloveni dhe Kroaci. Në shtator të vitit 1991 dezertoi nga ushtria jugosllave dhe iu bashkua Gardës Kombëtare Kroate. Në vitin 1992 emigroi në Gjermani. Më pas iu bashkua radhëve të UÇK-së. Ishte zëvendëskomandant i Brigadës 121 “Ismet Jashari-Kumanova”. Në mars të vitit 1999 u caktua komandant i Akademisë së UÇK-së. Në prill të po atij viti u emërua në detyrën e oficerit për operacione. Më përfundimin e luftës dhe demobilizimin e UÇK-së kreu detyra me përgjegjësi në Trupat Mbrojtëse të Kosovës dhe në Forcën e Sigurisë së Kosovës. (Haxhi Ferati)

SADRIU Isa (1963-). Futbollist, trajner. Lindi në Vushtrri. Karrierën si futbollist e nisi në moshë të re, në vitin 1976, në “Kosovën” e Vushtrrisë, ku luajti deri në vitin 1982. Më pas kaloi tri vjet te skuadra e “Trepçës” së Mitrovicës. Pas paraqitjeve të mira, ai u transferua te “Partizani” i Beogradit, ku luajti dy vjet. Nga Beogradi u kthye në Kosovë dhe veshi fanellën e “Prishtinës” për pesë vjet. Ishte pjesë e përfaqësueses së ish-Jugosllavisë në vitin 1985/86. Nga viti 1987 e deri më 1992 luajti në Suedi, te “Malmo”, e më pas kaloi te klubi “Hertha” e Berlinit, ku qëndroi deri në vitin 1999. Pas përfundimit të luftës ai u kthye në Kosovë, në fillim te “Gjilani” dhe pastaj te “Trepça”. Në vitin 2003 e mbylli karrierën e futbollit aktiv dhe u bë trajner i futbollit. Drejtoi “Kosovën” e Vushtrrisë, “Besianën” e Podujevës, “Ulpianën” e Lipjanit dhe grupmoshat e reja në shkollën e futbollit “Galatasaray Kosova” (“Beslidhja”). (Leutrim Mustafa)

SADRIU Liridon (1989). Tenor. Lindi në Ferizaj, ku kreu shkollën fillore dhe të mesme të muzikës. Më pas vazhdoi studimet në Fakultetin e Arteve në Prishtinë, në drejtimin e solokëndimit në klasën e prof. A. Dërgutit. Ka marrë pjesë në koncerte brenda e jashtë vendit,

si solist dhe si pjesëtar i Korit të Filarmonisë së Kosovës, apo me formacione të tjera vokale. Është për t’u theksuar pjesëmarrja e tij në koncertin “Tre tenorët” më 2015, që organizohet në Tiranë dhe që është nga manifestimet në zë në kryeqendrën shqiptare. Nga viti 2008 është anëtar i Korit të Filarmonisë së Kosovës, anëtar i Ansambllit vokal “Okteti plus”. Ka qenë edhe anëtar i korit “New Born”. (Kristina Palokaj-Perkola)

SAHATÇIU Besim (1935-2008). Regjisor filmi dhe teatri. Lindi në Pejë, ku kreu arsimin fillor dhe të mesëm. Akademinë e Filmit dhe të Teatrit e kreu në Zagreb. Punoi në TV Beograd, në redaksinë në gjuhën shqipe dhe në TV Prishtinë, në redaksinë e programit dokumentar dhe artistik. Realizoi dhjetëra filma dokumentarë, seriale televizive dhe disa filma artistikë. Me filmin dokumentar “117” mori



BESIM SAHATÇIU

çmimin “Gran prix” në Beograd (1978), ndërsa po ky film u shfaq në dhjetëra festivale ndërkombëtare. Ndërsa filmi artistik “Era dhe Lisi” (1979), prodhim i “Kosovafilmit dhe i TV Prishtinës, konsiderohet njëri ndër filmat më të mirë të Kosovës. B. Sahatçiu ishte ndër pionierët e filmit shqiptar në Kosovë, që kultivoi gati të gjitha llojet e filmave (dokumentarë, artistikë, filmat televizivë) dhe ndër regjisorët që përqafoi frymën e re filmike. Më vonë krijoi edhe filmat “Përroi vërshues”, një dramë për problemet e minatorëve dhe të punëtorëve në vlimet e reja politike. Filmi i radhës, “Tre vetë kapërcejnë malin” u xhirua në vitin 1980, mirëpo për shkaqe politike nuk u shfaq në publik. Realizoi edhe filmat dokumentarë dhe të metrazhit të shkurtër dhe filmat televizivë: “Bukë e kripë e zemër”, “Trimi”, “Pasqyra”, “Pehlivanët” etj. B. Sahatçiu bëri regji teatrore. Bëri regjinë edhe për një sërë shfaqjesh, kryesisht në Teatrin Popullor Krahinor: “Tartufi”, “Revizori”, “Lulet e dashurisë”, “Mizantropi”, “Ora”, “Dervishi dhe vdekja”, “Genci”, “Feniksi i shpejtë” etj. (Gani Mehmetaj)

SAHATÇIU Xhevdet (1962-). Kitarist, pedagog. Lindi në Pejë. Kreu studimet në Akademinë e Muzikës në Zagreb (1990) te prof. D.



XHEVDET
SAHATÇIU

Petrinjak. Po aty kreu dhe studimet pasuniversitare (2009). Punoi disa vjet në shkollën e muzikës “Pavao Markovac” në Zagreb, një kohë (2002) po në Zagreb ligjëroi në Akademinë e Muzikës dhe ishte docent në Fakultetin e Arteve, në departamenti i artit muzikor në Prishtinë. Puna e tij pedagogjike çmohet në Kosovë dhe në Kroaci, duke u vlerësuar edhe nxerrja e kitaristëve konkurentëve/garuesve të denjë, fitues shpërblimesh (ndër)kombëtare. Më 2004 Sahatçiu fitoi çmimin vjetor të Shoqatës së Pedagogëve të Muzikës e të Baletit në Kroaci. Ishte dhe vazhdon të jetë pjesëmarrës në gara e festivale europiane. Në vitet 2003-2009 është drejtues i këshillit të pedagogëve të kitarës, ndërsa më 2009-2014 drejtor i Shkollës së Muzikës në Novska (Kroaci). Sahatçiu është kryetar i Shoqatës Kroate të mësimdhënësve të kitarës, drejton disa shkolla verore në Kroaci dhe ka qenë anëtar jurie në shumë gara për kitarë. Është solist dhe anëtar i disa ansambleve kamerale në Kroaci dhe themelues i Garave ndërkombëtare “International Guitar Competition Ehat Musa” në Pejë. (Rreze Kryeziu-Breznica)

SAHITAJ Reshat (1952-). Shkrimtar, publicist. Lindi në fshatin Sopi të Therandës. Mësimet e para i mori në vendlindje, shkollën e mesme e kreu në Prizren, ndërsa Shkollën e Lartë Pedagogjike për aktrim në Prishtinë. Më 1979 emigroi në Belgjikë, ku për më shumë se dy dekada zhvilloi aktivitetet të dëndur politik, në mbështetje të çështjes së Kosovës. Shkruan tregime e romane, drama, skenarë filmash, komedi, shkrime publicistike. Si aktor luajti rolin kryesor në dramën “Sfinga e gjallë”, mandej në radio-dramën “Vdekja e Gjergjizit”, në filmin televiziv “Rropullari” dhe bëri regjinë e dramës “Procesi” të J. Gërvallës. Bëri dramatzimin e poezisë së Din Mehmetit “Kosova zog i diellit”. Në vitin 1982 botoi librin e parë me tregime “Rojtari i Shqipërisë së harruar”. Më pas botoi romanet: “Rruga pa kthim” (1983), “Mali i ndaluar” (2003), “Jeta e dyfishtë” (2005), “Dikur e diku” (2009), “Shtatë minutat e fundit” (2010) etj. Merret erdhe me përktthime nga frëngjishtja. Shkrimet e tij

publicistike janë botuar në gazeta dhe revista të ndryshme. (Nazmi Rrahmani)

SAHITI Ejup (1942-). Jurist, profesor universitar. Lindi në Keqekollë të Prishtinës. Në Prishtinë kreu Medresenë e Ulët, ndërsa Medresenë “Gazi Husrev Beg” e kreu në Sarajevë. Kreu studimet në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës (UP), kurse magjistroi në Fakultetin Juridik të Universitetit të Zagrebit. Tezën e disertacionit të doktoratës e mbrojti në Fakultetin Juridik të UP-së, ku në



EJUP SAHITI

vitin 1969 u zgjodh asistent për lëndën e drejta e procedurës penale. Po në këtë fakultet i arriti të gjithë titujt universitarë, përfshirë edhe titullin e profesorit ordinar. Nga themelimi ligjëroi edhe në Universitetin e Tetovës dhe në Universitetin e Europës Juglindore. Një mandat ishte delegat i Kuvendit të Kosovës. Gjatë periudhës 1999-2005, bashkë me ekspertë ndërkombëtarë dhe vendorë mori pjesë në hartimin e Kodit penal të Kosovës, të Kodit të procedurës penale, të Ligjit penal për të mitur, të Ligjin për ekzekutimin e sanksioneve penale dhe në disa ligje të tjera të fushës penale. Ka botuar tekstet universitare: “E drejta e procedurës penale” (2005), “Psikologjia gjyqësore” (2007), si dhe monografitë “Dëshmia e dëshmitarit si provë në procedurën penale” (1993) dhe “Argumentimi në procedurë penale” (1999). Ishte anëtar i këshillit programor për trajnimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në kuadër të Institutit Gjyqësor të Kosovës. (Ismet Salihu)

SAHITI Heset (1957-). Veprimtar politik, luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Lindi në Poturoc të Lipjanit. Punoi mësimdhënës në shkollën e mesme të Lipjanit. Në fillim të viteve '90 u përfshi në strukturat e Lidhjes Demoratike të Kosovës (LDK) të komunës së Lipjanit. Në gusht të vitit 1993 u arrestua dhe u dënua me 2 vjet burg, bashkë me grupin e Ministrisë së Mbrojtjes të Kosovës. Pas lirimimit nga burgu vazhdoi aktivitetin në kuadër të LDK-së deri më 1998, kur iu bashkua UÇK-së në Brigadën 121 “Ismet Jashari-Kumanova” në Kleçkë, ku kreu detyra të ndryshme komanduese. Pas luftës iu bashkua

radhëve të Partisë Demokratike të Kosovës dhe më pas Nismës për Kosovën. (Ruzhdi Jashari)

SAHITI Jashar (1920-1975). Funkzionar politik në Kosovën Lindore. Lindi në Preshevë. Gjatë Luftës së Dytë Botërore iu bashkua forcave që luftonin kundër fashizmit bullgar. Në vitin 1944 u internua në Gjermani. Pas luftës u angazhua për emancipimin dhe arsimimin e shqiptarëve të trevës së Luginës së Preshevës. Më 1950 u zgjodh kryetar i komunës së Preshevës. Si kryetar komune kundërshtoi përpjekjet e pushtetit qendror për t'i regjistruar si turq shqiptarët e kësaj zone. Gjatë viteve 1958-1962 ushtroi pozitën e sekretarit të Komitetit Komunal të Partisë Komuniste për Rrethin e Preshevës. Në vitet 1962-1966 zgjidhet sërish kryetar i komunës së Preshevës. Me angazhimin e tij, në shtator të vitit 1961 në Preshevë hapen paralelet e gjimnazit të Vranjës. Në vitin 1966 u zgjodh deputet federativ. Më pas ishte drejtor i ndërmarrjes "Bratsvo" në Preshevë. (Iilir Zylfiu)

SAHITI Muharrem (1965-). Futbollist, trajner. Lindi në fshatin Budrigë të komunës së Vitisë. Hapat e parë të futbollit i bëri te skuadra nga Gjilani "Cërvena Zvezda" në vitin 1985, para se të kalonte te Prishtina. Te KF "Prishtina" luajti për katër edicione dhe në vitin 1990 shkoi në Turqi, te skuadra "Konyaspor". Pas dy vjetësh të kaluara në Turqi, dy vjet të tjera luajti edhe te skuadra bullgare "Lokomotiv Plovdiv", më pas në vitin 1997 te skuadra zvicerane "Thun", ndërsa një vit më vonë luajti edhe në Gjermani, te "Oberneulandi". Në vitin 1999 u rikthye në Kosovë dhe luajti për skuadrën e "Gjilanit" deri në vitin 2002, kur u largua nga futbollit aktiv dhe u bë trajner i skuadrave të Superligës së Kosovës "Gjilani", "Drita" dhe "Hysi". (Tahir Sopi)

SAHITI Naser (1966-). Inxhinier i makinerisë, mësimdhënës universitar. Lindi në Caralevë të Shtimes, arsimimin bazë e mori në vendlindje, në Shtime dhe në Ferizaj, ndërsa studimet i kreu në Fakultetin e Makinerisë të Universitetit të Prishtinës (UP), të cilat i mbaroi më 1991. Në vitin 1996 u zgjodh bashkëpunëtor në Fakultetin e Makinerisë, ndërsa më vonë (1998) themelon marrëdhënie të rregullta pune. Më 2006 përfundoi studimet e doktoratës në Fakultetin Teknik të Universitetit të Erlangenit-Nyrnbergut (Gjermani). Ushtrio

detyra me përgjegjësi dhe funksione drejtuese në Fakultetin e Makinerisë dhe në UP. Ligjëron për kaldajat e avullit, eficiencën e energjisë dhe bazat e energjisë së ripërtëritshme. Botoi një sërë punimesh shkencore në revista të ndryshme dhe mori pjesë në konferenca ndërkombëtare. (Xhemajl Fejzullahu)

SAHITI Sahit (1944-). Mjeshtër zëri. Lindi në Prishtinë. Gjimnazin e mbaroi në Prishtinë. Punoi në Radio Prishtinë si mjeshtër zëri, ndërsa që nga viti 1969 në Radiotelevizionin e Beogradit, redaksia në gjuhën shqipe. Pas themelimit të Televizionit të Prishtinës (1974) emërohet udhëheqës i tonistëve deri në mbylljen e tij nga Serbia më 1990. Ishte mjeshtër zëri në filmat "Të ngjuarit", "Si të vdiset", "117" dhe i një sërë emisionesh televizive, dokumentare dhe artistike. Ishte pjesë e ekipeve televizive në shumë vende të botës, për të përgatitur ose përcjellë ngjarje të rëndësishme të kohës. (Shaqir Foniqi)

SAHITI Skënder (1955-). Hendbollist, trajner i hendbollit. Lindi në Ferizaj. Specializimin për hendboll e përfundoi në Itali. Aktivitetin sportiv e nisi si portier i "Borçit" të Ferizajt. Në këtë skuadër qëndroi nga viti 1972 e deri më 1987, ndërsa dy vjet mbrojti për "Bolonjën" e Italisë. Gjatë kohës që ishte portier i "Borçit", skuadra e Ferizajt ishte anëtar i ligës së parë të ish-Jugosllavisë. Pas vitit 1989 u bë trajner i Prishtinës dhe më pas në Itali, te skuadrat "Eors Sirakuza", "Mazard", "Bolzano" dhe "Casagrande" në Itali (2002-2009), klub i femrave me të cilin bëhet kampion i Italisë. Jeton dhe punon në Ferizaj. (Lulzim Shala)

SALAJ Hasan (1944-). Folës i Radiotelevizionit të Prishtinës. Lindi në Katërkollë, komuna e Ulqinit. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa shkollën normale e filloi në Nikshiq (Mal të Zi) dhe e kreu në Gjakovë. Një kohë të shkurtër punoi mësues në vendlindje dhe më pas studioi për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin Filozofik të Prishtinës. Punën e folësit në Radio Prishtinë e filloi në vitin 1965. Më 1974, me hapjen e Televizionit të Prishtinës, bëhet njëri nga spikerët e parë në këtë medium deri në mbyllje të tij më 1990. Më pas emigroi në SHBA, ku për disa vjet punoi në TV "Viktoria" në gjuhën shqipe në Nju-Jork. (Nehat Islami)

SALESIANËT. Pjesëtarë të kongregatës kato- like të themeluar nga Don Bosko (Giovanni Melchiorre Bosco, 1815-1888), pastor dhe pedagog italian. Salesianët e marrin emrin si- pas ipeshkvit të Gjenevës, Fransoa Sales (Fran- çois de Sales/Francesco di Sales, 1567-1622) dhe konsiderohen si dishepuj të tij. Anëtarë të kësaj kogregate janë të shpërndarë në tërë botën, përkatësisht në 132 vende të botës, duke përfshirë Shqipërinë dhe Kosovën. Në Kosovë qendrat edukative “Don Bosko” gjenden në Prishtinë dhe Gjilan. Qendra “Don Bosko” në Prishtinë u hap në tetor të vitit 2003, ndërkaq ajo në Gjilan në vitin 2013. Salesianët dhe salesianet në Shqipëri i ndeshim që nga koha e Don Gjon Boskos, objektivi i të cilit ishte sidomos arsimimi i rinisë shqiptare edhe në kushtet e sundimit osman. Në Shqipëri sot veprojnë dy qendra “Don Bosko”, në Tiranë dhe në Shkodër. Salezianët në Kosovë janë të pranishëm si pjesë e provincës së salezianëve sllovenë. Karizma e kësaj kongregate shprehet në kujdesin për rininë dhe formimin e saj për punë. (Muhamet Mala)

SALIEVA Salia (1950-). Balerinë. Lindi në Shkup. Për shumë vjet ishte pjesëtare e trupës së baletit të Teatrit Popullor Krahinor. Gjatë viteve ‘80 interpretoi në disa shfaqje baleti. Ndër rolet e realizuara veçohen: Vajza në “Vallja pranverore” të Gazmend Zajmit (1981), Spanjollja në “Kopelia” të Leo Delibit (1982), Partizanja në “Era dhe kolona” të Akil Koci (1983) etj. (Arian Krasniqi)

SALIHAMIXHIQI Nusret (1931-2011). Pi- ktor. Lindi në Zhabar të Mitrovicës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, Shkollën e Mesme të Artit në Pejë, ndërsa studimet në Akade-



NUSRET
SALIHAMIXHIQI

minë e Arteve Aplikative në Beograd, drejtimi i pikturës monumentale (1959). Një kohë punoi si ilustrator në NGB “Ri- lindja”, më pas në Gja- kovë si mësimdhënës i artit në shkollë të mes- me, ndërsa më 1970 në Shkollën Normale në Prishtinë. Në vitin 1975 nisi të punojë në Aka- deminë e Arteve në Prishtinë. Ishte anëtar i Shoqatës së Artistëve Figurativë të Kosovës dhe i Shoqatës së Artistëve Aplikativë të Kosovës.

Filloi të ekspozonte që herët, me prezantime të përbashkëta ose individuale: në Beograd (1968), në Sarajevë (1969), pastaj në Galerinë e Arteve në Prishtinë (1980, 2001), në Muzeun e Lojërave Olimpikë Dimërore në Sarajevë (1988), në Amsterdam (2009) etj., përfshirë edhe ekspozitën e fundit në të gjallë të piktorit në vitin 2011, në Galerinë e Arteve të Kosovës. Emërues i përbashkët i opusit të tij është “Loja”, të cilën e artikuloi mbi gjysmë shekulli. Sipas autorit bota është lojë qeniesh e gjallesash pa identitet, ose me identitet të fshehura apo të rremë, por edhe shpërthim, revoltë. Konside- rohet një nga artistët më të veçantë dhe më të papërsëritshëm të artit pamor të Kosovës. Mori pjesë në shumë ekspozita kolektive brenda dhe jashtë vendit: më 1968 në Trienalen IV në Beog- rad, në Sallonin Pranverore të Kosovës (1975, 1980, 1984, 1985, 1987), pastaj në ekspozitën “Arti Bashkëkohor i Kosovës” në Beograd, Za- greb, Dubrovnik, Kajro etj., si dhe më 1988 në ekspozitën “Dhjetë artistë të Kosovës” në Augsb- urg të Gjermanisë dhe në qendra të tjera euro- piane. Është fitues i disa çmimeve publike dhe profesionale dhe i mirënjohjeve të ndryshme: çmimi i fondit “Mosha Pijade” (1967), i Sallonit IV Pranveror të Kosovës (1977), i Bienales II të Vizatimit në Prishtinë etj. (Hivzi Muharremi)

SALIHAMIXHIQI Muhedin (1925-1995).

Mjek, neuropsikiatër, profesor universiteti. Lindi në Babule të Kavardarcit (Maqedoni). Kreu shkollimin fillor dhe të mesëm në Mi-




MUHEDIN
SALIHAMIXHIQI

trovicë, studimet në Fakultetin e Mjekësisë në Beograd (1962). Pas diplomimit punoi si mjek në Shtëpinë e Shën- detit në Gjakovë, ku një kohë ishte edhe drejtor. Në vitin 1966 kaloi në Spitalin e Përgjithshëm në Prishtinë, në repar- tin e neuropsikiatrisë. Mbaroi specializimin për neuropsikiatri në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Zagrebit (1969). Ishte neu-ropsikiatri i parë shqiptar i Kosovës. Ishte shef reparti dhe drejtor i Klinikës së Neuropsiki- atrisë për shumë vjet. Pas hapjes së Fakultetit të Mjekësisë u zgjodh ligjërues i neuropsiki- atrisë (1971). Mbrojti disertacionin e doktor- atës po në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë (1978) dhe më pas u zgjodh docent, pastaj

profesor inordinar dhe ordinar i lëndës së neuropsikiatrisë. Ishte edhe kryetar i Shoqatës së Neuropsikiatërve të ish-Jugosllavisë, kur dha dorëheqje, pasi u vendosën masat e dhunshme në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. Ka merita për ngritjen e shërbimit të neuropsikiatrisë në Kosovë. Është autor i një sërë punimesh shkencore të botuara në revista të ndryshme. (Afrim Blyta)

SALIHI Ihsan (1943-). Fotoreporter. Lindi në Prishtinë. Nga viti 1964 nis punën si fotoreporter në të përditshmen “Rilindja” dhe në këtë gazetë punoi deri në vitin 2002, kur përfundimisht ndërpritet dalja e saj. Fotografitë e tij përbëjnë kronikë të ngjarjeve më të rëndësishme të historisë më të re të Kosovës, në veçanti ato të periudhës pas vitit 1981 e deri në mbarim të luftës. Përveç në “Rilindje”, botoi fotografi edhe në të gjitha gazetat shqipe në Kosovë, në “Zërin e rinisë”, “Bujku”, “Shkëndija”, “Fjala”, “Kosovarja”, “Gazeta e pionierit” dhe në gazeta të tjera lokale. (Zenun Çelaj)

SALIHU Agim (1951-). Grafist. Lindi në Prishtinë. Kreu Akademinë e Arteve, drejtimi i grafikës, në Prishtinë (1977). Punoi si mësues në Akademinë e Arteve në Prishtinë, që



AGIM SALIHU

nga viti 1986, ku ligjëroi kaligrafinë me tipografi. Grafikat e tij realizohen me teknikën e akvaintës dhe bakërshkrimit dhe deri tani janë sistemuar në ciklet: “Demat”, “Mëngjesi i Orfeut”, “Madona”, “Agimi” dhe “Dritarja e zezë”. Në grafikat e para koloriti është më i çiltër, ndërsa në të mëvonshmet dominojnë e zeza dhe tekstura gri. U prezantua në një sërë ekspozitash personale brenda dhe jashtë vendit, si në “Italienska Palatset”, Waxjo, Suedi, në QKI “Imperial 1” në Shkup, pastaj në Galerinë e Arteve të Kosovës në Prishtinë, në “Galeria PI” në Stamboll, si dhe në Romë e Grosseto (Itali), në Suedi (me Sh. Gjurmajn), në Ulqin (në Galerinë e Kullës së Balshajve), në Galerinë “Schroder” në Augsburg të Gjermanisë, disa vjet radhazi në “Galeria KO” në kuadër të Kolonisë së Grozhnjanit etj. Gjithashtu mori pjesë në një sërë ekspozitash kolektive, si në Tokio, Mumbai, Lubjanë, Honolulu, Memfis, Uashington, Osa-

ka, Saporo, Rio de Zhaneiro, Buenos Aires, Havanë, Rijekë, Veneci, Glasgou etj. dhe u shpërblye me një sërë çmimesh prestigjioze. (Fatmir Krypa)

SALIHU Astrit (1966-). Filozof, publicist, mësues në universiteti. Lindi në Prishtinë, ku e mbaroi shkollën fillore dhe të mesme. Studimet për filozofi-sociologji i mbaroi në



ASTRIT SALIHU

Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës (UP). Doktoratën e mbaroi në Universitetin e Zagrebit (2008). U zgjodh asistent në departamentin e filozofisë të Fakultetit Filozofik të UP-së, ku vazhdon karrierën universitare si mësues në disa lëndë (hyrje në filozofi, filozofi antike, filozofi e masmedies etj.). Ishte redaktor në revistën “Njohja”, drejtor i Qendrës për Studime Humanistike “Gani Bobi” (1997-2002) etj. Ka botuar disa libra, kryesisht nga fusha specifike e interesimeve të tij, për modernen dhe postmodernen: “Diskursi filozofik i postmodernes” (1997), “Postmoderna e interpretuar për shqiptarët” (2005), “Aporitë e modernes, kritika e rrëfimeve të mëdha” (2013) etj. Është redaktor i disa botimeve në gjuhën shqipe, serbe, angleze dhe gjermane dhe autor i shumë artikujve të botuar në revista shkencore vendore dhe të jashtme nga filozofia, kultura, arkitektura dhe politika. Një kohë të shkurtër u mor me politikë. (Anton K. Berishaj).

SALIHU Avdi (1957-). Inxhinier i makinerisë, profesor universiteti. Lindi në Kovaçicë të Mitrovicës. Shkollën fillore dhe të mesme i përfundoi në Mitrovicë, ndërsa studimet në Fakultetin Teknik të Universitetit të Prishtinës (UP) (1981). Studimet pasuniversitare dhe disertacionin i kreu në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike të UP-së (2001). Punoi në Shkollën e Mesme Teknike në Mitrovicë dhe pastaj në kombinatin “Trepça”, në Fabrikën e Pajimeve të Procesit dhe në Fabrikën e Akumulatorëve. U zgjodh asistent dhe ligjërues në Shkollën e Lartë Teknike, ku merr edhe titujt e tjerë, përfshirë edhe titullin profesor i rregullt (2012) për lëndët e departamentit të makinerisë. Ushtri funksione drejtuese në Shkollën e Lartë Teknike, në Fakultetin e Shkencave Teknike të

Aplikuara dhe në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë. Mori pjesë në disa simpoziume dhe konferenca shkencore dhe botoi një sërë punimesh shkencore dhe profesionale. (Avni Terziqi)

SALIHU Aziz (1954-). Boksier. Lindi në Prishtinë. Ishte kampion i shumëfishhtë në ish-Jugosllavi në kategorinë super të rëndë. Ka qenë anëtar klubit të boksit “Prishtina”.



AZIZ SALIHU

Suksesi i tij më i madh ndërkombëtar ishte medalja e bronzit në Lojërat Olimpikë Verore në Los Anxhelos, SHBA, në vitin 1984, ku përfaqësoi ish-Jugosllavinë. Më parë Salihu mori pjesë në Lojërat Olimpikë Verore të Moskës më 1980 dhe në Seul më 1988. Në Kosovë A. Salihu është shpallur sportisti i shekullit. U angazhua për pavarësimin e sportit të Kosovës në vitin 1991, ndërsa dha ndihmesën e tij edhe në Komitetin Olimpik të Kosovës, ku për një kohë ishte zëvendëskryetar. (Albatri Matoshi)

SALIHU Bul (1980-). Gazetar. Lindi në Peran të Podujevës, ku kreu shkollën fillore, ndërsa të mesmen në Podujevë. Studimet i mbaroi në degën e shkencave politike në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Nga viti 2000 nisi punën si gazetar në të përditshmen “Kosova sot”, ndërsa nga 2001 deri në vitin 2004 punoi në gazetën e përditshme “Zëri”. Në vitin 2005 ishte në grupin themeluesve të “Gazetës Express”, ku punoi deri në vitin 2007. Ndërkohë filloi punën edhe në Televizionin “Alsat”, një herë si gazetar e pastaj si shef i zyrës së Prishtinës për 10 vjet me radhë. Së fundi është njëri nga themeluesit dhe pronarët e portalit “Politiko.net” dhe punon si drejtor menaxhues në Kosovë i kompanisë mediale “VEVE Grup”. (Artan Krasniqi)

SALIHU Faruk (1947-). Historian, profesor. Lindi në Prishtinë, ku kreu shkollën fillore dhe të mesme. Studimet për histori i kreu në Universitetin e Prishtinës (UP) më 1974, ku më pas kreu studimet pasuniversitare dhe mbrojti disertacionin e doktoratës (1983). Një kohë punoi mësimdhënës në shkollën teknike “19 Nëntori” në Prishtinë, ndërsa që nga viti


1974 ishte punonjës shkencor në Institutin e Historisë në Prishtinë. Në periudhën 2004-2006 ishte ligjërues i jashtëm në Fakultetin e Edukimit të UP-së në Gjakovë. Është autor i monografisë “Lidhja e Rinisë së Kosovës 1948-1978” (2005), si dhe i disa studimeve dhe trajtesave në revista shkencore të Kosovës etj. Mori pjesë në konferenca dhe simpoziume shkencore nga fusha e historisë. (Sulltane Ukaj)

SALIHU Hajdar (1950-1995). Lindi në fshatin Batushë të Gjakovës. Kreu shkollën fillore në vendlindje, Shkollën Normale në Gjakovë, ndërsa studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Universitetin e Prishtinës, ku më pas kreu edhe studimet pasuniversitare. Disa vjet punoi si mësimdhënës në gjimnazin e Deçanit, pastaj si aktor në Teatrin Popullor të Gjakovës. Shkroi kryesisht prozë dhe kritikë letrare. Bashkëpunoi me revistat letrare ku botoi shkrimet e tij, ku një kohë botoi me pseudonimin Yll Jonuzi. Botoi romanet: “Udha e ditës së nesërme” (1990), “Jerina dhe helmi” (1994), “Raport për jetë paralele” (1994), “Stina e mjegullës” (1999) dhe “Baladë për kthimin e nizamëve” (2005). Dy romanet e fundit u botuan pas vdekjes. Në vitin 2013 nga Ndërmarrja botuese “Jeta e re” u botua kompleti i veprave të plota në katër vëllime. Në veprën e plotë u përfshi edhe studimi “Poezia e bejtexhinjve” dhe një numër shkrimesh mbetur në dorëshkrim, si tregime dhe novela, studime dhe kritika letrare. (Hasan Hasani)

SALIHU Haxhi Sali (1859-1912). Veprimtar i lëvizjes kombëtare. Lindi në Pogradjë të Gjilanit. Medresenë e kreu në fshatin Dobërçan. Shërbeu si imam në vendlindje dhe në Përlepnice. Dallohej për bamirësi: ndërtoi një urë mbi lumin Morava, çezme dhe një mulli në fshat, si dhe bleu një truall në fshat, ku ndërtoi mejtepin, në të cilin zhvilloi edhe mësimin shqip. Gjatë viteve 1893-1901 punoi si mësues në mejtepin e Pogradjës. Mbajti kontakte me Idriz Seferin, dhe krerët e tjerë të Lëvizjes në Gjilan dhe rrethinë. Ishte aktiv në Lëvizjen e Turqve të Rinj. Organizoi pjesëmarrjen e luftëtarëve të kësaj treve në kryengritjen e vitit 1910, mori pjesë në Betejën e Kaçanikut dhe në betejat të tjera në Malësinë e Karadakut. Angazhoi luftëtarët e trevës së Pogradjës dhe fshatrave përreth në aksionet e armatosura kundër forcave osmane gjatë Kryengritjes së Përgjithshme të vitit 1912. Në

vjeshtë të atij viti, kur Aleanca Ballkanike i shpalli luftë Perandorisë Osmane, mori pjesë në mbrojtjen e trevave verilindore, kundër depërtimit të ushtrisë serbe. Nën komandën e tij u bashkëngjitën dhjetëra vullnetarë nga trevat e Karadakut dhe të Anamoravës, për t'i rezistuar Armatës së Tretë serbe në vijën kufitare të Merdarit. Ra në Sfirçë, në fushën e betejës. (Fitim Rifati)

SALIHU Ismet (1944-). Jurist, profesor universitar. Lindi në Ferizaj, ku kreu shkollimin fillor dhe të mesëm, ndërsa studimet në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës (UP).



ISMET SALIHU

Studimet pasuniversitare i mbaroi në Universitetin e Zagrebit, ndërsa doktoroi në Fakultetin Juridik të Universitetit të Lubjanës. Pas diplomimit punoi si gjyqtar në Gjykatën Komunale në Ferizaj, pastaj u zgjodh asistent për lëndën e drejta penale në Fakultetin Juridik, në të cilin kaloi nëpër të gjitha thirrjet universitare, deri në atë të profesorit të rregullt. Në vitin 1974/75 qëndroi për specializim në Universitetin e Sorbonës në Paris. Gjatë viteve 1975-1977 ishte anëtar i grupit për hartimin e Ligjit penal të KSA të Kosovës, ndërsa në periudhën 1988-1990 ka qenë kryetar i Shoqatës për të Drejtën Penale dhe Kriminologji të Kosovës. Në Fakultet Juridik të UP-së kreu detyra me përgjegjësi. Pas ndjekjes me dhunë prej objekteve universitare të studentëve dhe profesorëve shqiptarë nga regjimi serb, në dy mandate kreu detyrën e dekanit të Fakultetit Juridik në kushtet e mësimit në “shtëpi-shkollë”. Nga viti 1987 deri në vitin 1995 ishte kryeredaktor i revistës “E drejta” të Fakultetit Juridik. Ishte anëtar i komisionit për falje të dënimeve në kuadër të Kryesisë së KSA të Kosovës (1986-1989). Në vitin 1990, në cilësi të anëtarit të grupit punues, mori pjesë në përgatitjen e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, (Kushtetuta e Kaçanikut). Pas vitit 1999 ishte anëtar i Këshillit për Çështje Legjislative të UNMIK-ut, ku punoi në hartimin e Kodit penal të Kosovës dhe të Kodit të procedurës penale të Kosovës (të miratuar në vitin 2003). Botoi monografinë “Vrasjet në KSA të Kosovës” (1985), si dhe tekstet universitare: “E drejta penale-pjesa e përgjithshme”

(2005) dhe “E drejta penale-pjesa e posaçme” (2005), pastaj “E drejta penale ndërkombëtare” (2005) etj. Ka kryer detyra me përgjegjësi në institucionet e arsimit të lartë dhe në fushën e drejtësisë. (Ejup Sahiti)

SALIHU Jashar (1953-2000). Veprimtar i lëvizjes për çlirimin e Kosovës, Hero i Kosovës. Lindi në fshatin Botushë të Gjakovës. Kreu Normalen në Gjakovë, ndërsa studimet për gjuhë dhe letërsi angleze në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Një kohë punoi në gjimnazin e Deçanit. Pas demonstratave të vitit 1981 u arrestua dhe u dënua me katër vjet burg. Veprimtarinë politike e vazhdoi edhe pas daljes nga burgu. U angazhua edhe në aksionin e pajtimit të gjaqeve dhe ishte organizator dhe drejtues i tubimit të Verrat e Lukës më 1 maj të vitit 1990. Në fund të vitit 1991 dhe në fillim të vitit 1992 u arrestua edhe dy herë dhe u torturua nga policia serbe. Në vitin 1992 migroi në Zvicër, ku iu bashkua radhëve të Lëvizjes Popullore të Kosovës (LPK). Me themelimin e fondit “Vendlindja thërret” më 1993, J. Salihu u zgjodh kryetar i këshillit për administrimin e këtij fondi. Në kuadër të Drejtorisë Politike të UÇK-së, ishte anëtar i grupit për marrëdhënie me jashtë. Ishte edhe përfaqësuesi i parë diplomatik i Qeverisë së Përkohshme të Kosovës në Zvicër. Pas qershorit të vitit 1999 u kthye në Kosovë, ku punoi për sensibilizimin e opinionit ndërkombëtar për krimet serbe në Kosovë. Vdiq nga një sëmundje e rëndë në spitalin kantonal të Aargaut të Zvicrës. Në vitin 2013 u dekorua me Urdhrin “Hero i Kosovës”. (Ramadan Avdiu)

SALIHU Kurtesh (1940-2014). Jurist, profesor universitar. Lindi në Shtime, arsimimin bazë e mori në Prishtinë, ku i kreu edhe studimet universitare në Fakultetin Ekonomik-Juridik.



KURTESH SALIHU

Studimet pasuniversitare i kreu në Fakultetin Juridik të Universitetit të Zagrebit (1973), ndërsa doktoroi në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës (1977). Në vitin 1965 në Fakultetin Juridik zgjidhet asistent për lëndën e drejta kushtetuese dhe në vitet vijuese merr titujt përkatës universitarë, derisa më 1983

u zgjodh profesor ordinar. Krahas punës në Fakultetin Juridik, ka ushtruar edhe funksione të ndryshme politike dhe profesionale. Ishte gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës (1973-1978) dhe kryetari i saj (1978-1982), dekan i Fakultetit Juridik (1981-1983), kryetar i Komisionit për Çështje Kushtetuese i Kuvendit të Kosovës dhe delegat i Dhomës Federative të Kuvendit të Jugosllavisë (1986-1992). Botoi punime shkencore dhe tekste universitare ("Lindja, zhvillimi dhe aspektet e autonomisë së KSA të Kosovës në Jugosllavinë Socialiste", "E drejta kushtetuese" etj). (Arsim Bajrami)

SALIHU Linda (1970-). Pedagoge, mësimdhënëse universiteti. Lindi në Mitrovicë, ku kreu edhe shkollën fillore dhe gjimnazin. Studioi pedagogjinë në Fakultetin Filozofik në Prishtinë, ku edhe magjistroi (2000). Është mësimdhënëse e lëndëve pedagogjike në Fakultetin e Edukimit në Prishtinë. Fushë e interesimit të saj shkencor janë vështirësitë në nxënie dhe mirëqenia e fëmijëve. Është autore e disa punimeve profesionale dhe bashkautore e tekstit universitar "Të drejtat e fëmijës dhe etika e mësimdhënësit" (2006). (Afërdita Kumnova-Mulla)

SALIHU Milazim (1958). Xhirues filmi, producent, menaxher. Lindi në Karatmanovë, komuna e Shën Nikollës (Maqedoni). Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Ferizaj, ndërsa Akademinë për Teatër, Film dhe Televizion në Zagreb. Punoi në TV Prishtinë gjatë viteve 1982-1990. Në produksion të "Kosovafilmit" xhironi filmin e shkurtër "Dezha vu", si dhe një sërë emisionesh dhe filma dokumentarë, drama televizive dhe disa filma artistikë, në bashkëpunim me "Kosovafilmin" ("Lepuri me pesë këmbë", "Pikniku", "Proka" dhe "Njeriu prej dheu"). Ishte producent i një sërë emisionesh dokumentare me TV Lubjanën. Për minatorët e Trepçës realizoi filmin "Zogjtë në Kosovë", në prodhim të Televizionit Slloven. Ndërkaq, me Televizionin Kroat punoi disa emisione dokumentare në Shqipëri. Ishte producent i Radio Zagrebit për lajmet në gjuhën shqipe. Pas vitit 2000 udhëhoqi kinemanë ABC në Prishtinë, ku ishte drejtor dhe më pas menaxher i saj. Ishte producent në filmin "Agnus dei" të Agim Sopit. (Gani Mehmetaj)

SALIHU Mulla Mehmet (1898-1985). Titullar i fesë islame, bejtexhi. Lindi në fshatin Bresanë

të Opojës. Mësimet fetare së pari i mori nga i ati dhe, më pas, për 10 vjet me radhë mësoi te myderrizë dhe titullarë të tjerë të njohur të asaj kohe. Shërbeu si imam në disa vende të Kosovës, përfshirë edhe Xhaminë e Suharekës, ku shërbeu 13 vjet (1959-1972). U burgos dhe u dënua me tri vjet heqje lirie nga pushteti komunist jugosllav. La një krijimtari të pasur në dorëshkrim, kryesisht poezi shqipe me alfabet arab, por edhe vepra të tjera fetare ("Mevludi", "Hytbe të zgjedhura" etj.). (Resul Rexhepi)

SALIHU Remzi (1955-). Shkrimtar, përkthyes, botues. Lindi në fshatin Gajre të Tetovës. Arsimin fillor dhe të mesëm i kreu në Tetovë, kurse studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin Filozofik në Prishtinë. Disa vjet punoi në arsim, më pas në Zvicër. Është autor i librave: "Fluturimi i largët" (1987), "Sheshi i shtrigave" (1992), "Gjurmë malli" (1998). Ka përkthyer poezi të autorëve gjermanë, që janë botuar në gazeta e revista në gjuhën shqipe. Merret dhe me kritikë letrare. Është themelues i Shtëpisë Botuese "Ora-R". (Salajdin Salihu)

SALIHU Salajdin (1970-). Shkrimtar, gazetar. Lindi në Sllatinë të Tetovës, ku kreu shkollën fillore. Kreu shkollën e mesme dhe Fakultetin e Filologjisë në Tetovë. Mbaroi studimet pasuni-



SALAJDIN SALIHU

versitare në Prishtinë, kurse u doktorua në Universitetin e Shkupit. Disa vjet punoi si gazetar. Është autor i disa librave me poezi, prozë dhe ese. Ka botuar përmbledhjet poetike: "Vdes pas gjërave të imëta" (1996), "Nata e parë e pushtimit" (1998), "Gënjeshtër e sinqertë" (2004), "Natë e blertë vetmie" (2005), "Vonë për gjëra të turpshme" (2009), pastaj librat me ese: "Panteoni i utopisë" (1997), "Gjurmë" (2000), "Digresione I" (2008), "Digresione II" (2010) dhe "Zë në shkretëtirë" (2015), monografinë "Poetika e prozës së Murat Isakut" (2014) dhe librin universitar "Gazetaria, njohuri të përgjithshme" (2009). Ka shkruar pjesët skenike: "Vonesa" (2008) dhe është bashkautor i botimit "Dashuri, teatër dhe marrëzi të tjera" (2012), të vëna në skenë nga Teatri i Tetovës (2012). Shkrimet, poezitë dhe esetë e tij janë përkthyer në gjuhë të ndryshme

dhe janë përfshirë në antologji e panorama poetike. Është fitues i disa çmimeve për letërsi. Është mësimsdhënës në Universitetin e Tetovës. (Fatmir Sulejmani)

SALIHU Zejnel (1917-1943). Pjesëmarrës i Luftës Nacionalçlirimtare (LNÇ) në Kosovë. Lindi në Prishtinë, ku kreu shkollën fillore. Më 1936 u regjistrua në gjimnazin e Prishtinës. Në atë kohë ra në kontakt me idetë komuniste. Në mesin e të rinjve angazhohej për të drejta dhe barazi kombëtare e sociale. Me formimin e celulës komuniste në Prishtinë, Z.Saliu u bë i njohur për veprimet e tij revolucionare në mesin e të rinjve. Nga viti 1935 ishte anëtar Partisë Komuniste Jugosllve (PKJ), ndërsa më 1938 u zgjodh sekretar i celulës së PKJ-së në Prishtinë. Më 28 nëntor 1941, së bashkë me Meto Bajraktarin, organizuan në Prishtinë demonstratat e rinisë shkollore kundër fashizmit. Kishte ndikim në masën e të rinjve jo vetëm në Prishtinë, por edhe në Vushtrri e Podujevë, ku së bashku me Meto Bajraktarin kryenin aksione diversante. Me zgjerimin e LNÇ-së në Kosovë, më 1943, me direktivën Partisë, së bashku me një grup shokësh, i bashkëngjitet aradhes partizane “Emin Duraku”, që udhëhiqej nga Fadil Hoxha dhe që vepronte në atë kohë në malet e Lipovicës, në rrethin e Lipjanit. Më 14 prill 1943, Z. Saliu, së bashku me 11 shokë u rrethuan nga forcat fashiste italiane dhe në përballje me to u vranë të gjithë. (Alban Dobruna)

SALLONI PRANVEROR I KOSOVËS. Manifestim i organizuar nga Shoqata e Artistëve Figurativë të Kosovës (SHAFK), më vonë edhe nga Shoqata e Artistëve Aplikativë të Kosovës (SHAAK). Është ekspozitë tradicionale dhe organizohet çdo vit për nder të festave të majit. Salloni Pranveror i Arteve Figurative dhe Aplikative të Kosovës është revistë e veprave artistike të krijuesve të Kosovës. Deri në vitet '90 manifestimin e ka drejtuar Pleqësia e Sallonit Pranveror, e emëruar nga SHAFK-u, SHAAK-u dhe nga Galeria e Arteve e Kosovës. Ekspozita e parë është hapur në vitin 1974 në Prishtinë. Salloni është ndër ngjarjet më të veçanta kulturore në Kosovë. Ai u bë faktor i rëndësishëm i zhvillimit dhe i përparimit të identitetit kulturor e artistik. Në të janë ndarë çmime për fusha të ndryshme të artit figurativ. Përzgjedhja e punimeve zakonisht është bërë

nga komisionet profesionale, duke ruajtur nivelet e larta të prezantimit të arteve pamore dhe duke sjellë risitë e zhvillimeve më të fundit në këto fusha. (Hivzi Muharremi)

SAMOLICA. Vendbanim rural i tipit gjysmë të dendur, 14 km në jug të Bujanocit. Shtrihet në shpatet lindore të Rujanit, në anën e majtë të “Xhadës së Vjetër”, në lartësi mbidetare 460-510 m. Përbëhet prej katër lagjeve të ndara në tri tërësi fizionomike. Popullsia e fshatit u dyfishua gjatë periudhës 1948-2002, nga 599 banorë, në 1,390 banorë. Popullsia serbe, e cila kishte ardhur në fshat në vitin 1912, filloi të shpërngulet në fillim të viteve '60 të shekullit të kaluar. Banorët merren me bujqësi, ndërtimtari dhe zeje të tjera, kurse një pjesë e konsiderueshme ndodhen me punë të përkohshme në botën e jashtme. Nga objektet e standardit shoqëror, fshati ka shkollën fillore, e cila funksionon si paralele e ndarë e tetëvjeçares së Bilaçit. (Arsim Ejupi)

SANDFELD Kristian-Jensen (Christian) (1873–1942). Romanist dhe ballkanolog danez. Studimet për gjuhësi i mbaroi në Kopenhagë. Ishte profesor i filologjisë rumune po në Kopenhagë. Njihet si njëri ndër të parët që shpjegoi afritë midis gjuhëve ballkanike si rrjedhojë e bashkëjetesës së këtyre popujve. Më 1902 botoi artikullin për zhdukjen e infinitivit në gjuhët ballkanike dhe në gjuhën rumune, pastaj më 1926 në veprën që botoi në gjuhën daneze “Filologji ballkanike” (Balkanfilologien) shkroi për ngjashmëritë e shumta ndërmet këtyre gjuhëve, gjegjësisht në vitin 1930 në një version më të zgjeruar të kësaj vepre në gjuhën frënge (Linguistique Balkanique), me të cilën studimi i krahasuar i gjuhëve ballkanike mori formën dhe përmasat e një disipline të veçantë. K. Sandfeld mori në shqyrtim jo vetëm bashkëpërkime të përgjithshme ose të pjesshme midis gjuhëve ballkanike, sidomos në fushën e fjalorit dhe të gramatikës, por edhe huazimet e ndryshme leksikore. (Milote Sadiku)

SANEJA Mazllum (1945-). Poet, përkthyes letrar. Lindi në Gjakovë, ku kreu shkollimin fillor e të mesëm. Në Universitetin e Prishtinës kreu studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe, si dhe studimet pasuniversitare. Poet, eseist, M. Saneja njëkohësisht u mor dhe me përkthimin e



MAZLLUM SANEJA

Gjakova, Zhiti, disa antologji të poezisë shqipe etj.). Është autor doracakësh për mësimin e gjuhës shqipe ndër polakë. Botoi librat me poezi: “Këlthitje” (1973), “Heshtje e një kohe” (1976), “Shpuzë e ftohtë” (1988), “Shëmbëllime të trazuar” (1996), “Pe ndonjë ëndërr” (2003), “Vetëtimë jete” (2007), “Leximi i vetmisë” (2010) dhe “Letra Evës” (2014). Në polonisht, përkthyer nga ai dhe në bashkëpunim me Eva Shmjetanjskan botoi vëllimet me poezi “Udhëtime të purpurta” (1992), “Toka e zjarrtë” (1999), “Letra Evës” (2015) etj. Jeton prej vitesh në Poloni dhe është anëtar i disa organizatave letrare dhe të përkthyesve letrarë. Është laureat i çmimit prestigjioz polak “ZAIKS”. (Eqrem Basha)

SANËZA. (*Gentiana Luteae*) Bimë mjekuese, e njohur si Gentiana e Madhe, Gentiana e Verdhë. E mori emrin nga Genti, mbreti ilir, i cili e përdori për herë të parë si bimë mjekuese në shekullin II para epokës së re. Është bimë malore, më kërcell të fortë, me trashësi më të madhe se të gishtit. Kërcelli ka një gjatësi mbi 1 metër dhe është tërësisht i lëmuar. Në fund të kërcellit ka një fjongo të gjetheve, me një gjatësi 30 cm dhe gjerësi 15 cm. Lulet e mëdha me 5-6 petale ngjyrë të verdhë argjendi shpalosen në formë ylli, të grumbulluara nga 5-10 syresh. Farat që peshojnë 1 mg shpërndahen me erë. Bima është e përhapur në Alpet Shqiptare, por edhe në pjesë të tjera të hapësirave shqiptare. Përdoret për mjekimin e sëmundjeve të zëmrës (quhet edhe bari i zëmrës), por ka përdorim edhe më të gjerë në mjekësi, për problemet e tretjes, për përforsim të imunitetit, te rastet gripoze, apo të anemisë, kundër Gicht-it etj. (Mentor Disha)

SANTORI Françesk Anton (1819-1894). Poet arbëresh, dramaturg, romancier, satirist, fabulist, folklorist, një nga figurat e rëndësishme të përfaqësimit të letërsisë arbëreshe. U lind në

Picili (Santa Caterina Albanese), komunitet arbëresh në krahinën e Kozencës. Bir i prindërve të varfër, gjatë viteve të fëmijërisë studioi me ndihmën e famulltarit të fshatit. Që i ri shfaqti një dashuri për studimin dhe kulturën shqiptare. Më 1842 hyri në manastirin françeskan të Urdhrit të Reformuar në San Marko Arxhentano (Convento dei Riformati di San Marco Argentano). Atje jetoi tetëmbëdhjetë vjet deri më 1860. Edhe gjatë jetës si prift vazhdoi të studiojë dhe të krijojë vepra letrare që kontribuuan për ta ngritur gjuhën shqipe në nivelin e gjuhës letrare. Ishte orator i shkëlqyer dhe predikoi jo vetëm në famullitë kryesore të provincës, por edhe në Napoli. Nuk mundi të themelojë një manastir në Latariko (Lattarico) dhe braktisi jetën e murgut. I kthyer prapë në Picili, ai nisi t’i shtyjë ditët me një jetë modeste. Më 1885 u caktua prift në famullinë e Shën Jakut (San Giacomo di Cerzeto). Jetoi gjithë kohën në Kalabri, ku edhe vdiq në 7 shtator 1894, i trishtuar se shkrimet e tij në arbërishte nuk do ta shihnin kurrë dritën e botimit. Punoi si famullitar dhe si letrar, duke i lënë letërsisë shqipe një krijim letrar të gjerë dhe të shumanshëm. Është shkrimtari themelues i disa gjinive letrare në historinë e letërsisë shqipe. Në gjallje të tij Santori la pak vepra të botuara, duke mos i dhënë mundësi kritikës letrare të shpaloste përmasat e tij letrare. Ishte një djalosh i ri kur botoi veprën e parë “Il Canzoniere albanese”, vargje sentimentale me një frymëzim të dukshëm nga Petrarka. Më 1848 hyn në fuqi kushtetuta napoletane dhe Santori krijon poemthin “Valle harees madhe”, të cilën De Rada ia boton në gazetën “L’Albanese d’Italia”. Po në atë vit boton novelën në vargje “Il prigionero politico libero e reduce per la Costituzione del 1848” (Napoli, 1848). Më 1849 boton veprën me karakter fetar, të shkruar në gjuhën shqipe, “Rozarë i Shën Mëris Virgjërë të Mirvulis” (Kozencë, 1849); e ndjekur nga “Krështeu i shëjtëruorë” (Napoli, 1855), me një vlerë kryesisht historiko-gjuhësore, pasi përmban edhe shpjegime të alfabetëve të përdorura si edhe argumentime të zgjedhjeve të tij gjuhësore. Së fundmi u zbulua edhe romani “Bija e mallkuar” (La figlia maledetta, Kozencë 1863). Santori jetoi të gjithë jetën e tij në Kalabri dhe u shndërrua në një kronikan të kujdesshëm të realitetit të hidhur të asaj kohe. Shkrimet e tij ngjasojnë me një dokumentar të gjallë të jetës së arbëreshëve në fundshekullin e XIX. Prirja drejt

realizmit mbetet karakteri dominant i artit të tij. Me Santorin letërsia arbëreshe shfaq karakterin e saj social dhe shndërrohet në një letërsi të angazhuar. Si klerik, Santori është shumë pranë njerëzve që vuajnë, kështu që veprat e tij trajtojnë një problematikë që paraqet jetën e përditshme të popullsisë arbëreshe. Realizmin e tij social ai e derdh në veprat e tij në formë romani, novele në vargje, drame, tragjedi, melodrame, komedie, satire e fabule. Gjuha që ai përdor është e pasur dhe e pasuruar edhe me forma e shprehje nga shumë komunitete arbëreshe. Vepra e tij e mbetur për një kohë të gjatë në dorëshkrim po botohet e ribotohet në kujdesin e filologëve në formën e botimeve kritike. Janë në duar të publikut novelat në vargje “Brisandi, Lletixja e Ulladheni” (Fortino, 1977); “Panaini e Dellja - Fëmija pushtjerote” (Gradilone, 1979); “Tri novela” (Fortino, Stamile, Tocci, 1985); “I burgosuri politik” (Parise & Belluscio, 2014), dramati “Alles Dukagjini” (Solano, 1983), “Emira” (Solano, 1984); “Neomenia” (Meringolo, 2001); “Satirat” (Candrea & Shkurtaj, 1982); “Kalimeret” (Fortino, 2004), romanet “Sofia e Kominjatëve” (Bruçi, 2011) dhe “Bija e mallkuar” (Parise, 2014). Universiteti i Kalabrisë gjithashtu ka hedhur në rrjet një botim a ribotim elektronik të disa veprave me karakter fetar e letrar të Santorit të përgatitur nga Vincenzo Belmonte. Vetëm kur mozaiku i krijimtarisë letrare të jetë plotësuar edhe me vepra të tjera ende të pabotuara, kritika letrare mund të ridimensionojë edhe vendin që A. Santori zë në letërsinë shqipe. (Merita Bruçi)

SAPUNXHIU Riza (1925-2008). Politikan, ekonomist. Lindi në Pejë, shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, kurse Fakultetin Ekonomik në Universitetin e Beogradit.



RIZA SAPUNXHIU

Në vitet 1959-1960 ishte nënkryetar i komunës së Pejës, më pas drejtor në kombinatin e Lëkurë-Këpucëve në Pejë dhe nënkryetar i Këshillit Ekzekutiv Krahinor (1963-1969). Në periudhën 1973-1978 ushtroi detyrën e drejtorit të përgjithshëm të Bankës së Kosovës, kurse në vitin 1978 emërohet nënkryetar i Këshillit Ekzekutiv të Kosovës, e më 1981 u zgjodh kryetar i Këshillit Ekzekutiv. Në shtator të vitit

1982 emërohet drejtor ekzekutiv në Bankën Botërore në Uashington, si përfaqësues i ish-Jugosllavisë nga Kosova. Pas kthimit nga SHBA-ja, ishte guvernator i Bankës Popullore të Kosovës (1987-1989). Më 1989 u caktua nga Kosova anëtar i Kryesisë së Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (RSFJ). Gjatë periudhës sa ushtroi këtë funksion u përball me politikën antishqiptare dhe represionit serb në Kosovë, qëndroi në këtë pozitë edhe pas suprimimit të autonomisë së Kosovës, por u shkarkua nga Milloshviqi, kur kundërshtoi vendosjen e gjendjes së jashtëzakonshme në Kosovë (u zëvendësua me Sejdo Bajramoviqin). Në zgjedhjet e organizuara para luftës së vitit 1999 u zgjodh deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, ndërsa pas luftës ishte këshilltar i administratorit të UNMIK-ut për rajonin e Dukagjinit. (Nerxhivane G. Dauti)

SARAÇINI Eshref (1924-2005). Biolog, profesor universiteti. Lindi në Ferizaj, shkollën fillore dhe të mesme në Ferizaj, studioi biologjinë në Shkollën e Lartë Pedagogjike të Beogradit (1949) dhe në Universitetin e Shkupit (1964). Ishte mësimdhënës në Shkollën Normale, përkatësisht në Akademinë Pedagogjike të Shkupit. Mbajti mësim edhe në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore dhe në atë të Kulturës Fizike të Universitetit të Prishtinës. Fushë e interesimit të tij shkencor ishte herpetologjia, sidomos picërrakët. Mori pjesë në disa konferenca shkencore. Është autor, përkatësisht bashkautor i disa teksteve të biologjisë për shkollën fillore dhe të mesme, si dhe i atlaseve nga fusha e fiziologjisë dhe anatomisë. U angazhua për arsimin shqip në Maqedoni. (Hatixhe Vojka-Ismajl)

SARAÇINI Eugen (1957-). Gazetar. Lindi në Shkup, ku kreu edhe arsimin fillor dhe të mesëm, për të vazhduar studimet për gjuhë dhe letërsi angleze në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Punën e gazetarit e filloi më 1979 në Radiotelevizionin (RTV) e Maqedonisë, në sektorin e politikës të jashtme. Më 1985 filloi punë në RTV e Prishtinës, si producent i emisioneve dokumentare edhe nga kultura. Nga 1991 punoi korrespondent nga Kosova për televizionet nga Maqedonia. Në vitin 1995 bëhet korrespondent për Radion “Dojçe Velle” të Gjermanisë. Ka prodhuar një sërë dokumentarësh për periudhën e luftës në Kosovë, të cilat janë shfaqur në festivale të

ndryshme. Është bashkëthemelues dhe drejtor i programit informativ në RTV-21 në Kosovë dhe kryeredaktor në TV-21 në Maqedoni. Nga viti 2001 u angazhua në hendbollin e Kosovës, si kryetar i KH “Prishtina” dhe nga viti 2012 kryetar i Federatës së Hendbollit të Kosovës. Është anëtar i bordit ekzekutiv të Komitetit Olimpik të Kosovës. (Ibrahim Berisha)

SARAÇINI Valentina (1962-). Gazetare. Lindi në Shkup. Studioi për psikologji. Një kohë punoi në Televizionin e Prishtinës dhe nga viti 1982 në revistën “Zëri”, si gazetare dhe më pas redaktore. Ndërkohë studioi dhe u diplomua në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës. Gjatë viteve '90 ishte korrespondente nga Kosova e radios gjermane “Deutsche Welle” (DW), duke raportuar edhe nga zonat e luftës. Pas vitit 1999 ishte redaktore në redaksinë e programit shqip të Radios DW, pastaj punoi gazetare-analiste në Radiotelevizionin e Kosovës. Nga viti 2006 kaloi me punë në Radiotelevizionin “21”, si udhëheqëse e promovionit. Është autore e librave me poezi “Ushtrimi i vetmisë” (1996) dhe “Vjedhnajë ëndërrimi”, e cila më 2008 u botua edhe në gjuhën angleze, në SHBA. (Nehat Islami)

SARAÇINI-KELMENDI Afërdita (1955-). Gazetare. Shkollën fillore, të mesme dhe studimet për gjuhë dhe letërsisë shqipe i kreu në Shkup. Filloi të punonte si arsimtare në Shkup, ndërsa nga viti 1981 punoi gazetare dhe redaktore në Radio Prishtinë deri në vitin 1990, kur Radiotelevizioni i Prishtinës u mbyll nga Serbia. Në vitin 1991 fillimisht raportoi për “Radio-France International”, e më pas ishte korrespondente e Radios “Zëri i Amerikës”. Më 1995 themeloi qendrën e trajnimeve “Media Projekt”, pastaj magazinën mujore “Eritrea” dhe radiostacionin e parë shqiptar në internet, Radio-21. Është themeluese dhe bashkëpronare e RTV-21 dhe themeluese e televizionit TV-21 në Maqedoni. Është angazhuar në shoqata të ndryshme vendore e ndërkombëtare për të drejtat e grave dhe në asociacione të mediejeve elektronike të Kosovës. Është nderuar me shumë çmime dhe mirënjohje. (Ibrahim Berisha)

SARKOFAGU I ULPIANËS. Arkë e të vdekurit prej mermeri e periudhës romake. U zbulua në nekropolin verior, në ndërtesën e varrit të ashtuquajtur “Memorie” (1955). Është punuar në mermer të bardhë kristalor



të cilësisë së lartë, me kokrriza të mëdha dhe paraqet një punë mjaft cilësore. I takon tipit me kapak-kline. Është i tëri dhe pos dëmtimeve të vogla në arkë (236 x 128 x 121 cm.) dhe skajeve të kapakut (256 x 149 x 60 cm.), ishte i ruajtur deri në mars të vitit 2008, kur iu thye kapaku, i cili u renovua pas dy vitesh. Sarkofagu qarkohet nga një kornizë e gjerë e profiluar dhe në të tri anët është i rrethuar me një shirit të gjerë konkav, që ngrihet mbi bazament, duke formuar brenda një hapësirë në trajtë shtrati, në njërën anë të të cilit është skalitur jastëku. Arka e ka bazamentin e gjerë dhe të profiluar, që, sipas konstruktit, i përgjigjet sarkofagëve me kapak çati. Kjo tregon se arka dhe kapaku nuk i takojnë njëri-tjetrit, meqenëse arka pa dyshim u mbarua për kapak-çati, por më vonë iu dha forma kline.

Është karakteristike se ky ekzemplar nuk ka kurrfarë paraqitje figurative apo dekorative në arkë dhe kurrfarë figure të skalitur në kapak, ku zakonisht është i shtrirë një person apo çifti bashkëshortor. Prandaj, në pamje të parë mund të mendohet se sarkofagu është i pakryer, meqë sarkofagët nga guroret dhe punëtoritë e Prokonezit eksportoheshin edhe si gjysmëfabrikate, me motive dhe skena të skicuara, e pastaj përfundimi i tyre varej nga aftësitë e punëtorive vendëse. Në anën tjetër, edhe te sarkofagët e eksportuar atikë portretet në kline zakonisht vetëm skicoheshin në punëtori, kështu që në shumë raste kanë ngelur në atë gjendje. Në mesin e këtyre sarkofagëve ka edhe të tillë që në kapak, pos jastëkut, nuk është skalitur asnjë figurë. Një ekzemplar i tillë u gjet në Salonë (shk. III), kurse nga trevat e largëta një i tillë gjendet në Muzeun Shtetëror të Bejrutit. Në bazë të analogjive, mund të konstatohet se sarkofagu paraqet vepër të përfunduar dhe se skalitësi nuk e ka skalitur

me qëllim figurën/figurat në shtrat dhe as dekorimin në arkë, duke e lënë sipërfaqen me një zmallt të theksuar. Përkundër krahasimit me ekzemplarë të importit atik, lloji i mermerit nuk flet se është fjala për një import të tillë, si duket dhe nga profilet e arkës dhe forma e kapakut. Kështu, prejardhja e sarkofagut dhe vendpunimi i tij, edhe pse më parë duhet të jetë nga Azia e Vogël, mbetet të studiohet. Me llojin cilësor të mermerit, me përmasat e mëdha dhe punimin e përkryer, sarkofagu paraqet vepër monumentale, e krijuar rreth vitit 250. Ky është ekzemplar i rrallë me kapak-kline në Dardani, ndonëse sarkofag i fragmentuar me kapak-kline është gjetur edhe në Nish, por ky i takon importit atik. Sarkofagu i Ulpianës, ku është varrosur një çift bashkëshortor dhe inventari i të cilit është plaçkitur më herët, dëshmon praninë e një klientele shumë të pasur në Ulpianë. (Exhlale Dobruna-Salihu)

SARKOFAGU I VENDENISIT. Arkë e të vdekurit prej mermeri e periudhës romake. U gjet rastësisht te “Polanica” e Gllamnikut (1968), te nekropoli i vendbanimit antik Ven-



denis. Është punuar nga mermeri kristalor me ngjyrë të bardhë të shkëlqyer, me rremba gri. I takon tipit me kapak në formë çatie në dy ujëra. Përmban arkën (215 x 98 x 50 cm.) dhe kapakun (220 x 98 x 50 cm) dhe ka një të çarë të thellë të pjerrtë në mesin e kapakut. Arka ka vetëm bazamentin dhe kurorën të profiluar në tri anë, ndërsa kapaku është pajisur me akroterë të mëdhenj këndorë, prej të cilëve vetëm njëri në njërin faqe anësore është zbukuruar me motivin e gjysmëpalmetës së stilizuar dhe tjetri i skicuar me këtë motiv. Në dy faqet brenda fushave trekëndëshe të profiluara është skalitur nga një rozetë dhe vetëm njëra është përfunduar. Njëra anë është zbukuruar me motivin e

tjegullave harkore e të renditura në formë lus-pash (squamae), duke përfunduar me një brez të ngushtë të dekoruar me motiv gjeometrik, ndërsa ana tjetër është e papërpunuar. Kjo nënkupton se sarkofagu nuk është kryer ose nga kjo anë nuk ka qenë i dukshëm për shikuesin.

Sarkofagu paraqet ekzemplar unik të Dardanisë, me motivin e tjegullave, që ndeshet për herë të parë. Vetë motivi imiton kulmin e shtëpisë dhe, si i tillë, është i pranishëm te sarkofagët atikë të Azisë së Vogël, andaj nxirret përfundimi se sarkofagu i Vendenisit kishte për model atë atik apo oriental. Duke u nisur nga fakti se kjo mënyrë dekorimi u përvetësua edhe nga punëtoritë vendëse, këta sarkofagë ndeshen në shumë treva të perandorisë, si prodhime lokale apo si importe. Në trevat ilire janë zbuluar edhe në Salonë, Durrës, Butrint dhe Foinikë. Sarkofagu nuk është përfunduar dhe kjo dëshmon se është punuar në vend. Nga stili i punimit të pjesëve të kryera të një cilësie të lartë, mendohet se është punuar nga një mjeshtër i huaj, i cili duket se ka arritur bashkë me bllokun e mermerit për ta punuar në vend, me kërkesën e porositësit, gjë që praktikohet për sarkofagët e tillë. Lloji i mermerit tregon se është punuar nga mermeri prokonez i guroveve të Proconesusit antik (ishulli i Mermerit) në detin Marmara. Në Vendenis u eksportua si bllok përmes rrugës lumore nëpër Danub dhe Moravë Jugore deri te Nishi dhe pastaj përmes rrugës tokësore për në Lezhë. Në bazë të stolive cilësore të vajzës së varrosur në sarkofag, koha e punimit të tij është rreth shek. IV. Gjetet në Muzeun e Kosovës nga viti 2010. (Exhlale Dobruna-Salihu)

SASËT. Popullsia gjermane e ardhur në Kosovë në shek. XIV, për riaktivizimin e minierave të vjetra. Arsyet e vendosjes së sasëve në territorin e Kosovës janë të ndryshme. Disa mendojnë se ata u sollën nga sundimtarë të Rashës, tregtarët kotorras, raguzanë dhe italianë për t'i riaktivizuar minierat e moçme. Sipas mendimi të përhapur gjerësisht, atdhe i dytë i minatorëve sasë të ardhur në Kosovë ishte Hungaria, përkatësisht rajoni Cips, që sot është pjesë e Sllovakisë ose rajoni Siebenbürgen (Transilvania) i Rumanisë. Ka edhe një mendim se sasët do të kenë ardhur nga Klausenburgu (rum. Cluj) i Rumanisë, ku ishin vendosur pas shpërnguljes nga rajoni i Rinit të Poshtëm ose edhe nga Flandria në vitin 1144.

Kolonitë më të njohura të sasëve në Kosovën e sotme ishin në Novobërdë, Janjevë, Trepçë dhe në Bellasicë. Nga burime mësohet se Novobërda deri në fillim të shekullit XVI ishte kolonia më e rëndësishme e sasëve. Në rrethina të këtij qyteti mesjetar, emri etnik i sasëve është dëshmuar në një letër të princit Lazar të vitit 1380, kur përmendet edhe “Udha e sasëve” (*Sashki/ Saski put*), e cila lidhte Novobërdën me Janjevën. Ndërkaq, dëshmitë më të vjetra për praninë e sasëve në Trepçë i gjejmë në krisobulën e Banjskës (1313-1318), ku përmenden “Sasët e Trepçës” dhe në vitin 1446, kur mësohet se “in Sclauonia” ishte një vendbanim sas. Për Janjevën si koloni e madhe e sasëve nuk ka burime të shkruara dhe historia e tyre mbështetet kryesisht mbi relikte onomastike dhe leksikore. Kjo vlen edhe për koloninë sase në qytetin mesjetar të Bellasicës (Llap).

Në të gjitha kolonitë e tyre në hapësirën e Kosovës, sasët i kishin gjyqet dhe kishat e veta. Duke qenë se në qytetet-miniera të Kosovës sasët jetonin gjithmonë bashkë me raguzanët, në burime të shek. XIV emri i tyre dëshmohet shpesh në trajtat romane, përkatësisht italiane (*Teotonicus, Tedesco, Tudiescho* etj.). Në Janjevë një pjesë e sasëve u sllavizua, por nga mbetjet onomastike e leksikore sase në terren mund të supozohet se një pjesë e tyre mund të jetë shqiptarizuar. Shuarja e veprimtarisë së minatorëve sase nisi me pushtimin osman të Kosovës, kur xehetaria pësoi një rënie të ndjeshme, për t’u përmyllur kjo fazë në të mbaruar të shek. XVII: në vitin 1685, mbase për herë të fundit, përmenden “punëtorët e krishterë”, ku bënin pjesë sasët dhe raguzanët. Bashkë me raguzanët, sasët u shpërngulën në Raguzë dhe në qytetet e tjera të brigjeve të Adriatikut, por edhe në Itali e Hungari. (Skënder Gashi)

SAUKU Haxhi (1927-2010). Inxhinier i minierave, profesor universiteti. Lindi në Tiranë. Më 1947 filloi shkollën e lartë për inxhinier miniere në Ostravë të Çekosllovakisë, të cilën e mbaroi më 1952. U emërua mësues në Politeknikumin e Tiranës, më pas drejtor i Teknikumit të Minierave dhe Gjeologjisë në Përrenjas. Në periudhën 1963-1990 ishte pedagog në katedrën e minierave të Fakultetit të Gjeologjisë dhe të Minierave të Universitetit të Tiranës. U mor me punë shkencore nga

fusha e mekanikës së shkëmbinjve, për të cilën ngriti edhe laboratorin përkatës. Botoi tekste mësimore dhe vepra shkencore nga fusha e mekanikës së shkëmbinjve dhe minierave: “Mekanika e shkëmbinjve” (1971), “Ndërtimi i punimeve minerare (ushtrime dhe punë laboratorike)” (1986), “Mbi qëndrueshmërinë e masivit shkëmbor dhe bashkëveprimin shkëmb-armaturë” (1990) etj. Ka botuar një numër artikujsh shkencorë, përmbledhje studimesh dhe një sërë botimesh publicistike dhe letrare. Në vitet 1972-1980 ishte i angazhuar në mësimdhënie në Fakultetin e Xehetarisë dhe Metalurgjisë të Universitetit të Prishtinës në Mitrovicë. Ka mbajtur referat në kongrese dhe konferenca shkencore jashtë vendit dhe ishte anëtar i Komisionit Ndërkombëtar për Mekanikën e Shkëmbinjve të Dobët (ISCRM, 1993-1996). (Minir Dushi).

SAVICKA Irena (Irena Natalia Sawicka) (1944-). Gjuhëtare polake, sllaviste, ballkanologe. Lindi në Varshavë, ku kreu shkollën e mesme dhe fakultetin (1968), ndërsa doktoroi



IRENA SAVICKA

më 1972 me punimin për strukturën e grupeve të konsonanteve në gjuhët sllave. U habilitua më 1978. Prej vitit 1968 deri më 1992 punoi në Institutin për Studime Sllave në Akademinë e Shkencave të Polonisë, ndërsa më 1992 kaloi në departamentin e sllavistikës krahasimtare në Universitetin e Torunjit. Për shumë vjet ishte shefe e Institutit për Studime të Sllavistikës dhe të Studimeve Ballkanike. Është specialiste e fonetikës dhe e fonologjisë të gjuhëve sllave dhe të gjuhëve të Ballkanit, si dhe e tipologjisë dhe e gjuhësisë gjeografike, me vështrim të posaçëm gjuhët sllave të jugut dhe shqipen. Nga viti 2010 punon sërish në Institutin e Sllavistikës të Akademisë së Shkencave të Polonisë. Ka mbajtur mësim edhe në Universitetin e Poznanit. Ndër të arriturat e saj shënohet edhe puna pioniere në studimet e shqipes në Poloni, duke mbajtur edhe mësimet e shqipes në kuadër të ballkanistikës në Torun. Një ndër studimet e saj më të rëndësishme për shqipen është ai për strukturën e rrokjes në gjuhën shqipe dhe një studim për strukturën e rrokjes tek arbëreshët e Italisë. Që nga viti 1974 ka

publikuar 16 monografi dhe 7 tekste universitare. Ndër veprat më të rëndësishme të saj janë ato për strukturën e rrokjes në gjuhët ballkanike (1987), për fonologjinë e maqedonishtes standarde (1991), për fonologjinë kontrastive të polonishtes dhe të serbokroatishtes (1988), për fonologjinë kontrastive polako-bullgare, për tiparet fonologjike të unionit gjuhësor ballkanik (1997), për palatalet e gjuhëve sllave (1999), për fleksionin e shqipes (2005). Është redaktore e shumë publikimeve dhe anëtare e bordit e disa revistave shkencore. Është anëtare, mes tjerash, e Asociacionit Ndërkombëtar të Shkencave të Fonetikës, e Komisionit për Gjuhësi Ballkanike dhe e Komisionit për Kulturë dhe Histori të Ballkanit si dhe e Komisionit për Fonetikë dhe Fonologji Sllave të Komitetit Ndërkombëtar të Sllavistëve etj. Ka qenë pjesëmarrëse e Seminarit Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare si dhe e disa konferencave të gjuhësisë në Kosovë. (Lindita Rugova)

SAVIQ (Savić) Blagoje (1951-). Poet i letërsisë serbe nga Kosova. Lindi në Budrigën e Poshtme, afër Gjilanit. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, gjimnazin në Gjilan, ndërsa studimet e letërsisë jugosllave në Fakultetin Filozofik në Prishtinë. Ishte mësimdhënës në shkollat e mesme dhe më pas drejtor i Bibliotekës Popullore në Gjilan. Botoi disa libra me poezi: “Flas për herë të dytë” (1978), “Mbrëmje në sandale plastike” (1987), “Bishti i zi” (1989), “Kungimi në fushë” (1995), “Këndimi ditën e katërt” (2004), “Bota e zhvendosur” (2005). Është përfshirë në shumë përzgjedhje dhe antologji të poezisë bashkëkohore serbe. (Ismet Markoviq)

SAVIQ (Savić) Marko (1941-). Pianist, pedagog muzikor. Lindi në Prizren, ku kreu shkollimin fillor dhe të mesëm të muzikës. Kreu Akademinë e Muzikës në Beograd, drejtimi teorik-pedagogjik dhe për piano (1966). Studimet pasuniversitare i kreu në Shkup. Punoi në Prizren si mësimdhënës i pianos dhe korepetitor, më pas në Shkollën e Lartë Pedagogjike të Prishtinës dhe në vijim në Akademinë e Arteve. Ishte mësimdhënës dhe pianist i parë profesional dhe bashkëthemelues i drejtimin instrumental në Shkollën e Mesme të Muzikës në Prizren më 1978. U shqua për promovimin e veprave të kompozitorëve kosovarë. Nxënësit e tij fituan çmime në shumë

gara prestigjioze. Ka realizuar koncerte solistike dhe të përbashkëta në Prizren, Shkup, Prishtinë, Beograd etj. Jeton në Beograd. (Indira Çipa)

SAVOIA Leonardo M. (1948-). Gjuhëtar italian. Lindi në Firence. Studioi në Firence dhe në Shkollën Normale Superiore të Pisës. Ka dhënë mësim për fonetikën dhe fonologjinë



LEONARDO M. SAVOIA

në Universitetin e Kalabrisë dhe për gjuhësinë e përgjithshme në Universitetet e Ubinos dhe të Salernos. Më 1986 kaloi në Universitetin e Firences. Ishte dekan i Fakultetit të Edukimit të Universitetit të Firences (1986-1992 dhe 1992-

1998), anëtar korrespondent i Akademisë së Crusca-s dhe president i Shoqërisë Italiane të Gjuhësisë (SLI). Është anëtar i Komitetit Shkencor të revistës së gramatikës gjenerative dhe i gjuhës së sotme italiane. Mori pjesë si koordinator në projekte të ndryshme kërkimore me interes kombëtar. Studimet e tij u takojnë fushave të ndryshme të gjuhësisë. Është marrë me format morfosintaksore dhe fonologjike, me raportin teorik mes gjuhës dhe komunikimit, me studimin e dialekteve italiane, arbëreshe dhe të shqipes së Ballkanit dhe ka bërë studime për problematikën e teorisë gjuhësore, për situatat sociolinguistike e pragmatike dhe është marrë edhe me studimin e politikave gjuhësore, të minoriteteve gjuhësore etj. Disa prej veprave të tij që lidhen me shqipen janë: “Dialektet e italo-shqiptarëve dhe të Shqipërisë” (“I Dialetti Italo-albanesi e l’Albania, 2003), “Unifikim i morfologjisë dhe sintaksës. Hulumtime në dialektet romane dhe shqipe” (A Unification of Morphology and Syntax. Investigations into Romance and Albanian dialects, 2007); “Studime mbi varietetet arbëreshe” (Studi sulle varietà arbëreshe, 2008, 2012) etj. Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës ia botoi përmbledhjen “Studime në gjuhësinë shqiptare” (2015). (Kadire Binaj)

SAZONOV Sergejeviç Dmitri (1860-1927). Ministër i punëve të jashtme në qeverinë e Rusisë cariste. Lindi në Rjazan. Pasi përfundoi liceun “Carskoje Sello”, në vitin 1883 u emërua në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe, më vonë, u dërgua jashtë në poste të ndryshme

diplomatiqe në Londër, Vatikan dhe SHBA. Në vitin 1909 emërohet zëvendësministër i Punëve të Jashtme dhe një vit më vonë ministër i Jashtëm i Rusisë cariste. Në këtë funksion luajti rol të rëndësishëm në formimin e Aleancës Ballkanike, të cilën ishte i prirë që ta drejtojë kundër Austro-Hungarisë dhe jo kundër Turqisë. Pati rol të rëndësishëm edhe në formimin e Antantës, së bashku me Francën dhe Britaninë e Madhe. Nga këto dy të fundit, në vitin 1915 u sigurua se në rast fitoreje në Luftën e Parë Botërore, Rusia do të merrte nën kontroll Ngushticat e Bosforit dhe të Dardaneleve. Ishte aktiv në hartimin e Paktit të Fshehtë të Londrës (26.4.1913), që parashikonte copëtimin e Shqipërisë. Pas largimit nga detyra si ministër i Jashtëm, ishte pjesëmarrës aktiv në lëvizjen bjellogardiste. Ishte anëtar i qeverive të gjeneralëve A. V. Kollcak dhe A. I. Denikin. Në vitet 1919-1920 përfaqësoi rusët bjellogardistë në Konferencën e Paqes në Paris. (Islam Lauka)

SCUPI. Qendër e rëndësishme administrative, politike, religjioze dhe ekonomike dardane. Shtrihet në kodrën “Zajeçev Rid” te fshati Zllakuqan dhe lumenjve Lepenc dhe Vardar, rreth 5 km në veriperëndim të Shkupit. Fitoi statusin e kolonisë romake në kohën e sundimit të perandorit Domician gjatë viteve 84-85, duke u bërë kështu qendra e parë me këtë statut në gjithë Mezinë (Colonia Scupi Flavia Felix Domitiana). Kjo ka ndikuar në vërshimin e madh të të huajve, sidomos nga Lindja. Zhvillimin më të hovshëm e kishte në fund të shek. I-II dhe gjatë fillimit të shek. IV-518. Qyteti ishte i rrethuar me mure dhe shtrihej në sipërfaqe të madhe prej 43 ha. Infrastruktura përbëhej nga forumi, objektet publike dhe private luksoze, ujësjellësi, kanalizimet, muret mbrojtëse etj. U plaçkit nga gotët (279-280), kurse goditjen përfundimtare e mori nga tërmeti i vitit 518, pas të cilit nuk u rindërtua më dhe u braktis përfundimisht. Ishte qendër e rëndësishme religjioze dhe u ngrit në rangun e peshkopatës, duke u bërë kështu qendra kryesore kishtare në Dardani. Hulumtimet arkeologjike filluan midis dy luftërave botërore, kur u zbulua dhe teatri në pjesën veriore të qytetit. Gjatë gjermimeve sistematike, që filluan në vitet e '60 të shek. XX dhe që vazhdojnë ende, është konstatuar se qyteti kishte katër etapa ndërtimore gjatë periudhës romake, në veri dhe

qendër të tij. Etapës së parë i takojnë ndërtimet e hershme, siç ishte teatri i ndërtuar në shek. II. Etapës së dytë i takon horrea e fillimit të shek. III në qendër, mbi të cilën më vonë janë ndërtuar termet. Etapës së tretë i takon pjesa më e madhe objekteve të fundit të shek. III - fillimi i shek. IV, kur qyteti u përtëri me ndërtime intensive të objekteve të rëndësishme në të dy anët e qytetit: në qendër bazilika qytetare me mozaikë mbi objektet e fazës më të vjetër dhe termet, ku ka shenja edhe për forumin, dhe në veri vila qytetare me freska dhe termet e saj, një pjesë e të cilave është mbuluar nga bazilika e krishterë. Etapës së katërt i takon bazilika e krishterë me freska, e ndërtuar në veri (fund. shek. V-fill. shek. VI), e ndërtuar mbi një objekt të vjetër (ndoshta bazilikë), e cila ka mbetur e pakryer dhe në qendër ndërtesa me mozaikë në apsidë. Është zbuluar edhe rruga kryesore verijug (cardo maximus), me gypat qeramikë të ujësjellësit, me të cilën ishin të lidhura të gjitha objektet. Gjermime janë realizuar dhe ende vazhdojnë dhe në të tri nekropolet, atë lindore, perëndimore dhe jugore, të cilat kanë dhënë material të pasur të monumenteve mbivarrore të shek. I-IV.

Territori i gjerë (ageri) i kolonisë është përcaktuar në bazë të gurëve miliarë dhe mbishkrimeve të magjistratëve. Bazuar në këto fakte kufiri i tij ka ndjekur linjën vijuese: në lindje është përputhur me atë të provincës së Mëzisë së Epërme, përkatësisht të Dardanisë, duke përfshirë edhe trevën e Kumanovës; në veriperëndim ka shkuar deri te Karadaku, me çrast Kaçaniku ka mbetur jashtë territorit; në perëndim ka përfshirë fushëgropën Tetovë-Gostivar; nga verilindja ka shkuar nëpër luginën e Moravës Jugore, duke përfshirë trevat e Preshevës, Bujanocit, Vranjës dhe Vlladiçin Hanin deri te gryka e Gërdelicës, ku kufizohej me territorin municipal të Naisit. Kështu, e gjithë pjesa jugore dardane graviton nga ky qytet, i cili ishte edhe kryeqendër dardane: në kohën e Dioklecianit u bë qendër administrative e provincës së Dardanisë, në kohën e Konstantinit qendër ipeshkvnore dhe pas vitit 451 kryepeshkvi. (Exhlale Dobruna-Salihu)

SEBRËT. Popullsia e varur fshatare në Rashën mesjetare. Sipas administratës mesjetare rasiene, përkatësisht të dokumenteve ligjore të njohura edhe në Kosovë, Arbërinë Veriore,

Zetë e Dalmaci, sidomos gjatë shek. XIV, me *Sebar*, *Sebri* emërtoheshin personat që nuk i përkisnin klasës sunduese, aristokrate, fisnike dhe klerit, por popullsisë së varur fshatare. Në kategorinë e sebrëve hynin meropsët (parikët, bujqit), barinjët vllhë, zejtarët, sokalnikët (shërbëtorët) dhe otrokët (robërit, shërbëtorët në oborre aristokrate ose të sunduesve, apo bujqit në pronat e tyre). Në kuptimin e ngushtë të fjalës, sebrët ishin bujqit e lirë, veçanërisht ata që punonin me pjesëmarrje (qesim), përkatësisht “njeri me status më të ulët shoqëror” siç e ndeshim edhe në Kroaci. Sebrët dhe pozita e tyre juridike ishte çështje më vete në disa nene të Kodit të Dushanit, në “Sintagmën” e Matej Vlastarit dhe burime bizantine referente me të. Nga fillimet e shek. XV, sebrët i ndeshim edhe në dokumente raguzane, të cilat, duke ndjekur historinë e kolonive të tyre në hinterland, ofronin njohuri edhe për sebrët në qytete mesjetare të Kosovës. (Jahja Drançolli)

SEDAJ Engjëll (1943-2006). Albanolog, përkthyes, profesor. Lindi në Kabash të Vitisë. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa gjimnazin në Pazin të Kroacisë. Studioi




ENGJËLL SEDAJ

për filozofi në Fakultetin Teologjik në Zagreb dhe për filologji klasike në Shkup. Studimet pasuniversitare i ndoqi në Universitetin e Prishtinës. Më 1980 e mbrojti tezën e doktoratës për Homerin në letërsinë dhe në kulturën shqiptare. Disa herë qëndroi në Romë dhe në universitete të tjera të Italisë për kërkime shkencore. Një kohë punoi si mësimdhënës në gjimnazin e Ferizajt, kurse nga viti 1971 në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Ishte themelues dhe kryeredaktor i revistës “Dardania Sacra”. Me kumtesa e kontribute të tjera shkencore u paraqit në konferenca të ndryshme brenda dhe jashtë vendit. U mor me studime filologjike krahasuese, studime të letërsisë së vjetër shqipe, të letërsisë antike greko-romake, me hartimin e teksteve shkollore dhe universitare dhe me shkrime publicistike. Përktheu në shqip vepra të Aristotelit, të Virgjilit, të Horacit etj. Është autor i veprave “Homeri në letërsinë dhe kulturën shqiptare”

(1984), “Etnonimi Arbëresh-Shqiptar” (1996), “Etnoklutura në peshojë” (2000) etj. (Agnesa Hasimja)

SEDLARI Banush (1880-1948). Veprimtar i lëvizjes çlirimtare dhe antikomuniste. Lindi në fshatin Sedllar të Lipjanit. Ishte pjesëmarrës i kryengritjeve antiosmane të shqiptarëve gjatë viteve 1910-1912. Më vonë hyri në Çetën e Drenicës së Epërme, e cila ishte formuar me kërkesën e Nazim Gafurrit. Mori pjesë në luftën e Merdarit (1912) kundër ushtrisë serbe, së bashku me vëllanë e tij Ramadanin, i cili u vra. Gjatë Luftës së Parë Botërore luftoi pushtimin bullgar. Nga viti 1918 deri më 1933 u zgjodh kryetar komune në Sedllar. U angazhua kundër vendosjes së kolonëve serbë në Drenicë dhe kundër shpërnguljes së shqiptarëve në Turqi. Pas vrasjes së Ramë Bllacës (1933) emigroi në Shqipëri. Atje mbeti deri në vitin 1941. U kthye gjatë Luftës së Dytë Botërore. Pas vrasjes së Milladin Popoviqit, djali i tij, Ibrahim, u burgos me motivacion se kishte organizuar atentatin. Për këtë arsye u dënua me vdekje. Fillimisht me vdekje u gjykua edhe B. Sedllari, por më pas dënimi iu zvogëluar në 20 vjet burg. Vdiq në burgun e Nishit. (Fehmi Pushkolli)

SEFA Ruzhdi (1952-). Inxhinier i elektroteknikës, profesor universiteti. Lindi në Gjakovë, ku kreu shkollimin fillor dhe të mesëm. Studimet e inxhinierisë elektrike i kreu në



RUZHDI SEFA

Fakultetin Teknik të Universitetit të Prishtinës (UP) (1976). Studimet e magistraturës i kreu në Fakultetin Elektroteknik të Universitetit të Zagrebit (1979), ndërsa disertacionin e mbrojti në UP (2000). Pas diplomimit punësohet në kombinatin ndërtimor “Dukagjini” në Gjakovë, më 1976 u zgjodh ligjërues dhe më pas merr titujt përkatës universitarë (profesor i rregullt, 2011) për lëndët: bazat e elektroteknikës, elektromagnetika dhe përhapja e valëve, antenat dhe analiza e sistemeve elektroenergjetike. Ushtrroi detyra dhe funksione të ndryshme në Fakultetin Elektroteknik dhe në UP, ishte aktiv në asociacione për të drejtat e njeriut dhe në shoqata humanitare. Në periudhën 2002-2004 u angazhua në Institucionet e

Përkohshme Vetëqeverisëse të Kosovës. Është autor i një sërë publikimesh të botuara në revista brenda dhe jashtë vendit dhe pjesëmarrës në konferenca të ndryshme në Kosovë, në vendet e rajonit dhe më gjerë. (Ali Gashi).

SEFAJ Bajram (1941-). Shkrimtar, gazetar. Lindi në fshatin Novosellë të Pejës. Kreu shkollën fillore në vendlindje, të mesmen në Pejë, ndërsa studimet për drejtësi i mbaroi në Prishtinë. Punoi si gazetar në "Rilindje", pastaj në gazetën "Vjesnik" të Zagrebit dhe gazetar e redaktor në Televizionin e Prishtinës. Me shkrime nisi të merret që nga vitet '60. Shkruan kryesisht prozë, por edhe poezi për të rritur dhe për fëmijë. Ka të botuar librat me tregime: "Tri pika" (1980), "Rruga deri në kallëzim" (1983), "Java ka shtatë ditë" (1983), "Blu e gri" (1995); librat me novela: "Shëtitje ëndrrash" (1997), "Sa është ora" (2006), dhe romanet: "Parisi kot" (2003) "Terra nulltas" (2009) "Ani çka" (2012). Ka botuar edhe vëllimin me poezi "Në ecje" (2005), si dhe dramën "(S`)ikin dritat" (2011). Nga veprimtaria e tij shumëvjeçare publicistike dhe pjesëmarrja në aktivitete e manifestime të ndryshme, takimet me personalitete të ndryshme, vizitat që u ka bërë shumë vendeve, ka të botuar edhe librat publicistikë: "Shenjë kohe - signum temporis" (1998), "Gazetaria ime" (2007), "Plot Shqipëri" (2008) dhe "Shpen` udhëtar" (2014). (Nazmi Rrahmani)

SEFAJ Fatime (1956-). Aktore. Lindi në Novosellë të Pejës. Kreu studimet për aktrim, në drejtimin e artit dramatik të Shkollës së Lartë Pedagogjike në Prishtinë. Në Teatrin Krahinor



FATIME SEFAJ

u inkuadrua në vitin 1975. Ishte e angazhuar në projektet të rëndësishme të këtij teatri. Disa prej tyre janë: "Vdekja më vjen prej syve të tillë" me regji të F. Hysajt, "Krushqit janë të ngrirë" në regji të P. Manit, "Bregu i pikëllimit" me regji të V. Milçinit, "Qeleshbardhët" në regji të E. Kryeziut, "Nëna shkon në parajsë" në regji të B. Sahatçiu, "Ermira" në regji të S. Imerit, "Aleksandër Moisiu" në regji të A. Selimit, pastaj në monodramën "Gala" në regji: I. Qosjes. etj. Mori pjesë në filmat "Era e Lisi", "Pikniku", "Kolonel bunkerit", "Njeriu prej

dheu", "Der Albanier" dhe "Kodi i jetës". (Selman Jusufi)

SEFERI Idriz (1847-1927). Prijës i Lëvizjes Kombëtare dhe i luftës për pavarësi. Lindi në fshatin Sefer të Karadakut. Që kur ishte i ri u përball me çetat serbe në Hogosht të Kamenicës, ku u plagos. Në vitin




IDRIZ SEFERI

1875, në një betejë në afërsi të Preshevës kundër një trupe ushtarake osmane, u plagos sërisht, u kap dhe u dënua me 101 vjet burg. Deri në fund të jetës i kishte mbajtur dy plumba në kokë dhe një në qafë. Pas Luftës ruse-osmane u lirua nga burgju. Mbrojti viset shqiptare të Vranjës, Leskocit e Gjilanit nga invazioni i ushtrisë serbe më 1877/78. Ishte anëtar i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (1878-1881) dhe mbajti lidhje me Sulejman Vokshin, Mic Sokolin, Ali Ibër Nezën etj. Mori pjesë në Kryengritjen e Drenicës e të Shalës së Bajgorës më 1893 dhe në Kuvendin e Pejës (23-29 janar 1899), përkrah Haxhi Zekës dhe Bajram Currit. Në korrik të vitit 1907 u përball me çetën e komitëve serbë të Pasjanit në Gjilan. Luajti rol të rëndësishëm në organizmin dhe mbarëvajtjen e Kuvendit të Ferizajt (5-23 korrik 1908) dhe organizoi disa tubime kundër regjimit xhonturk, për çka u burgos në Gjilan, por më pas u lirua. Së bashku me Isa Boletinin dhe prijës të tjerë, ishte organizatori kryesor i Kryengritjes së Vilajetit të Kosovës më 1910. Bashkë me mijëra vullnetarë luftoi kundër ushtrisë osmane në Grykë të Kaçanikut më 23 prill 1910. Në këtë periudhë udhëhoqi kryengritësit e trevave verilindore në betejat e Drenogllavës, Pozhoranit, Smirës, Nikocit, Kurbalisë etj. U dënua me vdekje në mungesë nga Gjyqi Ushtarak Osman. Ishte ndër prijësit kryesorë të Kryengritjes së Përgjithshme të vitit 1912, përkrah Hasan Prishtinës, Isa Boletinit, Bajram Currit etj. Ndihmoi dhe mori pjesë në Kuvendin e Junikut më 1912, organizoi tubime e kuvende në rrethinën e Gjilanit dhe më gjerë dhe mori pjesë në çlirimin e qyteteve të Kosovës dhe të Shkupit, më 12 gusht 1912. Organizoi dhe udhëhoqi qëndresën e armatosur të shqiptarëve kundër depërtimit të ushtrisë serbe në tetor të vitit 1912 në vijën e kufirit Merdar-Kumanovë. Në nëntor të vitit 1912 u kap nga ushtria serbe

në rrethinën e Shkupit dhe u mbajt i burgosur në Beograd, ndërsa u lirua në prill të vitit 1913. Kundërshtoi vendimet e Konferencës së Ambasadorëve në Londër (1912-1913) për copëtimin e Shqipërisë. Deri në vitin 1915 luftoi pushtimin dhe administrimin serb në Kosovë, ndërsa në vitin 1916 u emërua drejtues i komunës së Zhegrës, por gjatë një përlëshjeje të armatosur me forcat bullgare u kap dhe u mbajt në burg deri në vitin 1918. Gjithashtu kundërshtoi vendimet e Konferencës së Paqes së Versajës (1919-1920). Vdiq dhe u varros në Zhegër të Gjilanit. (Fitim Rifati).

SEGONI Martin (shek.XV-XVI). Historian dhe ipeshkëv i Ulqinit nga Novobërda. Njoftimet e para lidhen me rindërtimin e dorëshkrimeve të tij. Është cituar nga historianët më me zë humanistë: M. A. Sabeliko, M. Beçikemi, P. Jovius, M. Orbini etj. Vepra jo e plotë e Segonit në origjinalin latinisht dhe diçka e përkthyer në italishte, është ruajtur vetëm nga historiani italian S. Razzi (1589). Disa vepra të tjera kanë mbetur të njohura vetëm sipas titujve. Nga dorëshkrimet e ruajtura nuk dimë shumë për jetën e tij. Dokumentet raguzane dhe venedikase dëshmojnë se Segoni ishte nga Novobërda dhe ishte ipeshkëv i Ulqinit. Në ballina të teksteve origjinale latine për të thuhet: *natione Catharensis* (kombësia kotorrane), Novobërda ishte vendlindja e tij, ndërsa në Ulqin ishte ipeshkëv (1482-1485). Arkivat e Padovës dëshmojnë se kishte studiuar në Universitetin e Padovës (1474-1475), ku kishte mbrojtur doktoratën nga e drejta kanonike (1475). Që në atë kohë kishte mbajtur lidhje me vendlindjen, Novobërdën. Ishte emëruar për kanonik në kishën Shën Mëria të Novobërdës (*Santa Maria in Nouamonte*). Pjesën më të madhe të shkrimeve M. Segoni ia kushtoi historisë arbërore: shkroi biografinë e parë kushtuar Gjergj Kastriotit-Skënderbeut: “Rrëfim mbi Gjergj Kastriotin, nga turqit, në gjuhën e tyre, i quajtur Skander Beg, domethënë Aleksandër i Madh” (rreth viteve 1481-1485). Janë të njohura edhe shkrimet historiko-geografike: “Traktati mbi mbrojtjen e Otrantit dhe rregullimi ushtarak i Turkut dhe origjina e tij”, “Mbi rrugët nga të cilat duhet sulmuar turqit”, “Mbi trevat e Dalmacisë prej të cilave barbarët ndër marrin sulme në vende gjermane” etj. (Jahja Drançolli)

SEJDIU Fatmir (1951-). President i Republikës së Kosovës, politikan, jurist. Lindi në Pakashticë



FATMIR SEJDIU

të Podujevës. Diplomoi në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës (UP), ku kreu edhe studimet pasuniversitare dhe doktoratën. Ishte profesor i rregullt në Fakultetin Juridik dhe në atë të Shkencave Politike të UP-së. Qëndroi për studime të thelluara në Francë (Universiteti Paris 2) dhe në SHBA (në Universitetin Shtetëror të Arizonës). Publikoi punime shkencore nga fusha juridike-historike dhe juridike-kushtetuese, si dhe libra të veçantë nga këto fusha. Ishte anëtar i kryesisë dhe sekretar i Shoqatës së Pavarur të Mësimdhënësve të Universitetit të Prishtinës, e cila e riorganizoi funksionimin e Universitetit të Prishtinës pas mbylljes nga organet serbe. Ka mbajtur ligjërata në universitete të ndryshme, në Europë dhe në SHBA. Ishte pjesëmarrës i kuvendit themelues të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) më 23 dhjetor 1989. Në kuvendin e parë zgjedhor, në vitin 1991, u zgjodh anëtar i këshillit të përgjithshëm dhe më 1992 anëtar i kryesisë së LDK-së. Në vitet 1994-1998 dhe 2004-2006 ishte sekretar i përgjithshëm i LDK-së, kurse nga dhjetori i vitit 2006 deri në nëntor të vitit 2010 ishte kryetar i LDK-së. Ishte anëtar i komisionit qendror për organizimin e Referendimit për Pavarësinë e Kosovës, të mbajtur në shtator të vitit 1991, deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës (1992, 1998) dhe sekretar i përgjithshëm i Kuvendit dhe kryetar i Komisionit për Çështje Kushtetuese (1998). Më 2001, në zgjedhjet e para demokratike të pasluftës, u zgjedh deputet në Kuvendin e Kosovës dhe anëtar i Kryesisë së Kuvendit (i rizgjedhur më 2004). Më 10 shkurt 2006 u zgjodh presidenti i Republikës së Kosovës dhe u rizgjodh më 9 janar të vitit 2008, funksion që e ushtroi deri më 27 shtator 2010, kur dha dorëheqje, pasi Gjykata Kushtetuese e Kosovës konstatoi se kishte shkelur Kushtetutën e vendit si president, duke mbajtur edhe postin e kryetarit të LDK-së. Gjatë kohës që ushtroi detyrën e presidentit të vendit, udhëhoqi delegacionin e Kosovës në bisedimet ndërkombëtare për përcaktimin e statusit final të Kosovës dhe ishte pjesëmarrës aktiv në aktin e shpalljes së Pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008. Është nderuar me çmime dhe dekorata. (Nerxhivane G. Dauti)

SEJDIU Fehmi (1932-2011). Gazetar i sportit. Lindi në Pakashticë të Podujevës. Si gazetar i sportit filloi të punojë nga viti 1958 në gazetën "Rilindja", ku vazhdoi deri më 1989. Ishte i njohur si analist i boksit. Ka ndjekur shumë breza të boksierëve tanë. Ishte edhe kryetar i Federatës së Boksit të Kosovës për dy mandate dhe anëtar i Kryesisë së Federatës së Boksit të ish-Jugosllavisë. Me raportet, komentet dhe analizat e tij dha kontribut për popullarizimin e këtij sporti në Kosovë. (Baki Berisha)

SEJDIU Pleurat (1963-). Veprimtar, përfaqësues politik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) në Londër. Lindi në Podujevë. Kreu shkollimin fillor dhe të mesëm në Prishtinë, ndërsa studimet në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetin e Krajovës në Rumani. U specializua në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës në Prishtinë në lëmin e kirurgjisë ortopedike. Në vitet 1997-1999 kreu detyrën e përfaqësuesit politik të UÇK-së në Londër. Gjatë Konferencës së Rambujes, me kërkesë të Shtabit të Përgjithshëm qëndroi në Rambuje, në mbështetje të delegacionit të Kosovës. Pas përfundimit të luftës, nga shtatori i vitit 1999 deri në shkurt të vitit 2000 ishte zëvendësministër i Punëve të Jashtme në Qeverinë e Përkohshme të Kosovës. Më vonë në strukturat e përbashkëta të administrimit të përkohshëm të UNMIK-ut kreu detyrat e bashkëdrejtuesit të Departamentit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale. Në institucionet e Kosovës ushtroi pozita të ndryshme drejtuese. Është kirurg ortoped në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës në Prishtinë. (Ismet Cakiqi)

SEJDIU Sejdi (1960-1998). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), dëshmor. Lindi në fshatin Nerodime e Poshtme të Ferizajt. Në vitin 1982 Gjykata e Qarkut në Prishtinë e dënoi me tri vjet burg për veprimtari ilegale. Në vitin 1987 filloi të punojë si mësësimdhënës në shkollën fillore në Jezerc dhe Dremjak. Në vitin 1993 emigroi në Zvicër, ku zhvilloi aktivitetin në kuadër të Lëvizjes Popullore të Kosovës. Me fillimin e luftës u kthye në Kosovë dhe u sistemua në Nënzonën Operative të Pashtrikut në Budakovë-Llanisht dhe më pas në fshatin Jezerc. Më 28 shtator 1998 si komandant i pikës së 2-të në Jezerc u vra në luftë e sipër së bashku me 8 bashkëluftëtarë të tjerë. (Ruzhdi Jashari)

SEJDIU Shaban (1959-). Mundës. Lindi në Shkup. Hapat e parë në sport i filloi në klubin e mundjes "Liria" të Shkupit, nën drejtimin e trajnerit Muntas Allajbegu. Gara e tij e parë ndërkombëtare ishte Kampionati Ballkanik i vitit 1974, ku edhe zuri vendin e katërt. Një vit më vonë, po në Kampionatin Ballkanik për të rinj në Ankara të Turqisë fitoi medaljen e artë.



SHABAN SEJDIU

Në Lojërat e Mesdheut në Algjeri fitoi medaljen e artë dhe më 1976 medaljen e argjendtë në Kampionatin Europian për të Rinj në Poloni. Ky sukses ia mundësoi paraqitjen në Lojërat Olimpike të Montrealit (1976). Pas një viti fitoi edhe medaljen e artë në Kampionatin Europian në Bursë të Turqisë (1977), më pas merr vendin e parë në Kampionatin Ballkanik në Athinë (1977) dhe doli i dyti në Kampionatin Botëror në Lozanë të Zvicrës (1977). Në vitin 1981, në Kampionati Botëror në Shkup fitoi medaljen e argjendtë. Në dy vitet e ardhshme u paraqit edhe në Lojërat e Mesdheut në Marok (1983), ku fitoi medaljen e bronzit, si dhe në Kampionatin Europian në Hungari, ku fitoi medaljen e argjendtë. Me këto rezultate siguroi pjesëmarrjen për Lojërat e Teta Olimpikë Verore. Në vitin 1991 e përfundoi karrierën e mundësit aktiv. Pas kësaj për një kohë ishte përzgjedhës i përfaqësueses së ish-Jugosllavisë për të rinj dhe u vu në krye të përfaqësueses së Maqedonisë në mundje. Jeton në Shkup. (Lulzim Shala)

SEJDIU Shefki (1936-). Gjuhëtar, profesor. Lindi në Pakashticë (Albonë), komuna e Bësanës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, të mesmen në Prishtinë. Studimet për filologji



SHEFKI SEJDIU

romane i përfundoi në Shkup, studimet pasuniversitare në Zagreb, ku edhe mbrojti tezën e disertacionit (1985). Prej vitit 1972 është ligjërues, docent dhe profesor ordinar i historisë së gjuhës frënge me frëngjishte të vjetër dhe i latinishtes në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës. Është anëtar i disa asociacioneve shkencore. Specializoi në Paris, Zagreb,

Bukuresht, Sofje dhe Londër. Përktheu dhe përshtati tekste të gjuhës frënge për shkollat fillore dhe të mesme. Është autor i studimeve monografike të domenit të onomasiologjisë dhe ka botuar studime për fitoniminë. Disa nga veprat e botuara: “Fjalorth etnobotanik i shqipes” (1984), “Çështje të onomasiologjisë fitonimike romane dhe ballkanike” (1989), “Sprava etimologjike” (2002), “Sisteme, struktura, raporte (etnolingvistika)” (2002) etj. (Agnesa Hasimja)

SEJDIU-BIBA Shqipe (1957-). Gazetare. Lindi në Hotle të Kumanovës. Më 1979 mbaroi Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës, degën e gazetarisë. Gjatë viteve 1979-1985 punoi gazetare në Radiotelevizionin e Prishtinës, në redaksinë e programit dokumentar. Më 1985 së bashku me familjen emigroi në SHBA, Nju-Jork. Në vitin 1990 ishte pjesëmarrëse aktive në themelimin e degës së Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) në Nju-Jork. Po atë vit hap radion e LDK-së, të cilën e udhëhoqi deri pas përfundimit të luftës në Kosovë (1999). Nga viti 1991 udhëhoqi seksionin për SHBA dhe Kanada të Qendrës për Informim të Kosovës (QIK). Në vitin 1992 hapi shkollën shqipe “28 Nëntori” në Staten Island të Nju-Jorkut dhe më 1993 themeloi organizatën e gruas “Motrat Qiriazit”. Për disa vjet drejtoi programin televiziv javor në kuadër të “Albaninan TV” në Nju-Jork, ndërsa ishte organizatore e koncerteve humanitare në shumë qytete të Amerikës në ndihmë Kosovës gjatë luftës. (Ibrahim Berisha)

SEJDIU-RUGOVA Linditë (1975-). Gjuhëtare, profesore. Lindi në Vranjë. Shkollimin fillor dhe të mesëm i kreu në Bujanoc, studimet për gjuhë dhe letërsi angleze në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës (1998). Më pas po në Universitetin e Prishtinës kreu studimet pasuniversitare dhe më 2008 mbrojti tezën e disertacionit të doktoratës në fushën e studimeve kontrastive sintaksore



LINDITË
SEJDIU-RUGOVA

të shqipes dhe të anglishtes. Më 2009 u zgjodh profesor asistent, ndërsa më 2013 profesor i asociuar. Dy mandate ka qenë prodekane për shkencë në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës dhe dekane po në këtë

fakultet. Është bashkautore e librit “Hyrje në gramatikën e tekstit të gjuhës shqipe”. Botoi artikuj në revista shqiptare dhe të huaja, kryesisht nga fusha e sintaksës. Është trajnuese e certifikuar për gjuhën angleze. Ka bërë specializime në SHBA dhe Angli. (Imri Badallaj)

SEJFIJA Osman (1948-). Mjek, stomatolog, kirurg maksilofacial, profesor universiteti. Lindi në Glllogjan të Deçanit, shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në Pejë, studimet në Fakultetin e Stomatologjisë në Beograd (1972). Mbaroi studimet pasuniversitare në Akademinë e Mjekësisë Ushtarake në Beograd, ndërsa disertacionin e doktoratës e mbrojti më 1986 në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. Mori titullin profesor inordinar dhe ordinar i lëndës kirurgji maksilofaciale. Një kohë punoi si stomatolog në Qendrën Medicinale në Pejë, më pas në Shtëpinë e Shëndetit në Prishtinë. Gjatë viteve '90 ishte prodekan i Fakultetit të Mjekësisë; gjatë luftës u doli në ndihmë të plagosurve dhe të zhvendosurve gjithandej Kosovës. Mori pjesë në shumë kongrese e simpoziume dhe publikoi një sërë punimesh shkencore si autor dhe bashkautor. Është anëtar i Shoqatës së Kirurgëve Maksilofaciale dhe Oralë të Britanisë së Madhe, themelues i Shoqatës së Kirurgëve Maksilofaciale dhe Oralë të Kosovës dhe anëtar i Shoqatës së Kirurgëve Kraniomaksilofaciale të Europës. (Fatmir Dragidella)

SEJFULLAI Elmir (1980-). Aktor. Lindi në Bogovinë të Tetovës. Në Tetovë kreu shkollën fillore, të mesme dhe Fakultetin e Arteve, dega e aktrimit. Luajti mbi 30 role në teatër dhe filma të shkurtër. Shfaqjet ku është shquar si aktor janë: “Njeriu që pa vdekjen me sy”, “Lavirja e denjë për respekt”, “Duke pritur Godonë”, “Kaos atdhedashurie në Paris”, “Hamleti në teatrin tonë”, “Shtëpia pa atdhe”, “Me grusht tehut të thikës”. Ka luajtur në filmat e shkurtër: “Falsifikatori”, “Pamja e fundit” dhe “Fotografia”. Është anëtar i trupës së Teatrit të Tetovës. (Salajdin Salihu)

SEJKO Veis (-1985). Mbledhës dhe studiues i folklorit. Lindi në Konispol të Çamërisë. Kreu gjimnazin në Shkodër dhe në Krushevc (Serbi), sepse ishte i përndjekur nga pushteti në Shqipëri. Shkroi edhe me pseudonimin Mark Mikelini. Studimet për drejtësi i filloi

në Beograd, por u arrestua për shkak të një artikulli të botuar, ku kishte denoncuar dhunën e serbëve ndaj kosovarëve. Pa të drejtë qëndrimi në Jugosllavi dhe i dënuar në mungesë në Shqipëri, studimet për drejtësi i kreu në Itali. Refuzoi të punonte për fashizmin, prandaj u dënua disa herë. Pas Luftës së Dytë Botërore punoi në Ministrinë e Drejtësisë dhe më pas avokat deri në suprimimin e avokaturës. U pensionua si cigareshitës. Ishte mbledhës i zellshëm i folklorit. Vepra e tij kryesore "Mbi elementet e përbashkëta në epikën shqiptaro-arbëreshe dhe serbokroate" u botua më 2002, pas vdekjes. Sejko ishte ndër pionierët e parë të studimeve krahasuese të këngës popullore të Ballkanit. I trajtoi shkencërisht raportet e këngës ballkanike, sidomos ato të eposit serb e shqiptar dhe të ciklit të këngëve për Betejën e Kosovës të vitit 1389. (Arbnora Dushi)

SEKIRAQA Shkumbin (1985-). Gazetar i sportit. Lindi në Prishtinë, ku kreu shkollën fillore dhe të mesme. Kreu studimet në Kolegjin ISPE. Në vitin 2004 nisi punën në gazetën "Koha ditore", si gazetar i sportit. Krahas teksteve për sportin vendor, merret edhe me përkthimin e teksteve të huaja nga bota e sportit. (Arsim Maxhera)

SELACI Ahmet (1896-1947). Luftëtar anti-komunist. Lindi në Selac të Shalës së Bajgorës. Më 1935 u zgjodh kryetar komune në Shalë, detyrë që e kreu deri në nëntor të vitit 1944. Si kryetar komune ndihmoi minatorët grevistë të "Trepçës" më 1936, 1937 dhe 1939. Në periudhën shtator-dhjetor 1941, me Pajazit Boletin dhe vullnetarët e Shalës mbrojti popullatën civile të Leposaviqit dhe Novi Pazarit nga sulmet e çetnikëve serbë. Më 1944 luftoi kundër njësiteve partizane, ndërsa më 1945 kishte nën komandë rreth 40 luftëtarë, me të cilët vazhdoi qëndresën dhe siguroi punimet e Kongresit të Lipovicës. Më 11 gusht 1946, në Kuvendin e Mrizishtës, ku morën pjesë edhe krerë të rezistencës të kësaj ane, u zgjodh komandant i divizioni "Ibri", i cili vepronte në kuadër të Lëvizjes Nacional-Demokratike Shqiptare dhe të "Besës Kombëtare". Pas disa tentimeve, më 19 shkurt 1947 njësitet e OZN-ës arrijnë ta likuidojnë, bashkë me 11 luftëtarët e tij. Në mesin e të vrarëve ishte edhe Faik Boletini, i biri i Isa Boletinit. Kufomat e të vrarëve u ekspozuan para portës së qytetit në

Mitrovicë. Pas shtatë ditësh OZN-a i varrosi në breg të lumit Ibër, në një varrezë të përbashkët. (Zijadin Gashi)

SELCA-MEHA Nexhmije (1953-). Balerinë, koreografe, pedagoge. Lindi në Pejë, ku edhe e kreu shkollimin fillor, kurse Shkollën e Mesme të Baletit e kreu në Shkup (1972). I



NEXHMIJE
SELCA-MEHA

takon gjeneratës së parë të trupës së baletit të Kosovës dhe nga viti 1972 e deri në vitin 1990 punoi në ansamblin e baletit të Teatrit Popullor Krahinor. Gjatë kësaj periudhe interpretoi në të gjitha shfaqjet e rëndësishme të baletit, në shumicën e shfaqjeve në role të rëndësishme: "Halili e Hajrija", "Sokoli e Mirushja", "Besa", "Bolero", "Inter-play", "Peter Pani", "Vallja pranverore", "Zhizela", "Era dhe Kolona", "Loja e Sizifit", "Kënga e Rexhës", "E bukura more", "Fyelltari", "Karmen" etj. Mori pjesë edhe në shumë shfaqje teatrore, kryesisht me pika të baletit, në mesin e të cilave: "Gjenerali i ushtrisë së vdekur", "Nastasja Filipovna", "Vdekja më vjen prej syve të tillë", "Emira", "Konfiteori" etj. Është autore e një numri koreografish të punuara kryesisht pas vitit 1999: "Lamenti", "Varri i qyqes" etj. Nga viti 2000 deri në vitin 2008 në Akademinë e Arteve në Prishtinë ligjëroi lëndën përgatitje skenike për aktor. Në vitin 2002 në Gjermani kreu specializimin për metodikën e baletit klasik në "Hamburg Ballet School". (Besim Rexhaj)

SELCA Rustem (1952-). Balerin. Lindi në fshatin Bshatin Baran të komunës së Pejës. Shkollën e mesme të baletit e mbaroi në Shkup dhe nga viti 1972 u bë pjesë e trupës së baletit në Teatrin Popullor të Kosovës, ku realizoi një mori rolesh në shfaqjet: "Ritme të zgjuara", "Paralodje dasme", "Sokoli e Mirusha", "Legjenda mbi ngadhënjimin", "Halili e Hajrija", "Vallja pranverore", "Bolero dhe Shtrausiana", "Interpley", "Kopelia", "Romeo e Xhuljeta", "Besa", "Zef Lush Marku", "Pjetër Pani", "Loja e Sizifit" etj. Në lojën e tij kishte ekspresion dhe finesë, që e bënë të trajtohej si primabalerin i ansamblit të baletit. (Selman Jusufi)

SELIMAJ Rexhep (1969-). Inxhinier i maki-nerisë, profesor universiteti. Lindi në Haxhaj

të Pejës, shkollimin fillor dhe të mesëm i kreu në Pejë, ndërsa studimet në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike të Universitetit të Prishtinës (UP). Pas diplomimit punoi si mësimdhënës në shkollat e mesme teknike në Istog dhe në Pejë. Që nga viti 2002 punon në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike të UP-së, fillimisht si asistent e më pas profesor në departamentin e termoteknikës dhe të termoenergjetikës. Kreu studimet pasuniversitare dhe mbrojti disertacionin po në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike të UP-së (2006). Është autor i një sërë punimesh shkencore të botuara në revista shkencore brenda dhe jashtë vendit. Është autor i tekstit universitar “Makinat termike” dhe bashkautor i tekstit “Instalimet makinerike” Ka bërë vizita studimore në disa universitete të Gjermanisë. (Xhemajl Fejzullahu)

SELIMI Abedin (1943-). Mësimdhënës, aktivist. Lindi në Preshevë. Shkollën fillore e kreu në Preshevë, të mesmen trivjeçare gjithashtu në Preshevë, ndërsa Shkollën e Mesme Ekonomike e mbaroi në Gjilan. Më pas filloi studimet në Akademinë Pedagogjike në Shkup dhe degën e gjuhës dhe të letërsisë shqipe në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Zë punë në gjimnazin “Skënderbeu” në Preshevë (1969), më pas emërohet drejtor i po këtij gjimnazi. U zgjodh kryetar i Kuvendit Komunal të Preshevës në vitin 1978. Pas zhvillimeve politike të vitit 1981, detyrohet të tërhiqet nga funksioni dhe gjatë viteve 1982-1986 ushtroi detyrën e drejtorit në fabrikën “Metal”, ndërsa më vonë bëhet drejtor në shkollën fillore “22 Dhjetori” në Corroticë të Preshevës. Në periudhën 1993-2012 ishte i angazhuar në Këshillin për Pajtim në Luginën e Preshevës. (Ilir Zylfiu).

SELIMI Agim (1963-). Regjisor, mësimdhënës universitar. Lindi në Prishtinë, ku kreu shkollën fillore dhe të mesme. Më 1991 përfundoi studimet në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës (UP), kurse u specializua për psikiatri në Qendrën Klinike Universitare në Tiranë. Në vitin 1996 mbaroi Fakultetin e Regjisë së Teatrit në Akademinë e Arteve të Bukura të Universitetit të Tiranës. Me punën e tij prej regjisor i është aktiv që nga fillimi i viteve '90, kur realizoi një numër shfaqjesh në skenën e Akademisë së Arteve në Tiranë, si: “Rinoqeronti” “Engjëlli i stacionit”, pastaj “Xhaxha



AGIM SELIMI

Vanja” në Teatrin Kombëtar të Kosovës (TKK). Më pas realizoi një numër shfaqjesh të dramaturgjisë kombëtare: “Trenat” në TKK dhe “Si e mposhta Musolinin” në Teatrin e Gjakovës, “Darka publike” në Teatrin e Gjilanit, “Liza po fle” në TKK etj. Ndërkaq, në vitin 2012 realizoi regjinë e shfaqjeve “Në mbrojtje të njeriut të shpellës” në Teatrin “Dodona” në Prishtinë, pastaj “Një letër e humbur” në Teatrin e Prizrenit. Më pas radhiten shfaqjet “Vorbulla” në TKK dhe “Dinjiteti” në Teatrin “Istref Begolli” në Pejë. Në periudhën 2005-2012 ishte drejtor i Teatrit të Qytetit të Prishtinës “Dodona”, ndërsa nga viti 1999 është pedagog i lëndës së regjisë së teatrit në Fakultetin e Arteve të UP-së, ku vazhdon të punojë. Më 2016 u zgjodh dekan i këtij fakulteti. (Besim Rexhaj)

SELIMI Halil (1958-). Veprimtar i lëvizjes kombëtare. Lindi në fshatin Ilincë të komunës së Preshevës. Pasi kreu shkollën e mesme në Preshevë, mbaroi studimet për gjuhë dhe letërsi në Universitetin e Prishtinës. Më 1979 u regjistrua në Fakultetin Xehetar-Metalurgjik në Mitrovicë. Në atë kohë u inkuadrua në lëvizjen ilegale studentore (Lëvizja Çlirimtare Kombëtare e Kosovës), organizoi celulën e parë për Preshevë dhe Bujanoc të kësaj lëvizjeje dhe u bë njëri nga udhëheqësit e kësaj organizate. Në dhjetor 1981 u arrestua dhe u dënua me 8 vjet burg. Pas daljes nga burgu, në vitin 1989 zhvilloi aktivitet në komitetin drejtues të Organizatës Marksiste-Leniniste të Kosovës (OMLK) dhe në Lëvizjen Popullore për Republikën e Kosovës (LPRK), më pas në Shoqatën e Pavarur Demokratike të Preshevës dhe në Partinë Demokratike Shqiptare (PDSH). Ishte kryetar i këshillit të Preshevës për referendumin e 1-2 marsit të vitit 1991 të Kosovës Lindore. Në maj 1998 u emërua përgjegjës i zyrës ndërlidhëse të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe të Fondit “Vendlindja thërret” në Tiranë. Ishte bashkëthemelues i Partisë së Progresit Demokratik të Kosovës, më vonë Partia Demokratike e Kosovës. Gjatë luftës së Ushtrisë Çlirimtare për Preshevë, Medvegjë e Bujanoc (UÇPMB) ishte anëtar i Këshillit Politik, i ngarkuar për marrëdhënie

me publikun dhe anëtar i grupit negociator të Luginës së Preshevës në bisedimet me përfaqësues të Serbinë në vitit 2001, të ndërmjetësuar nga komuniteti ndërkombëtar. (Fehari Ramadani)

SELIMI Jusuf (1924-1990). Gazetar. Lindi në Nasalcë të Bujanocit. Shkollën fillore e kreu në fshatin e lindjes, kurse shkollën e mesme në Pejë. Kreu Shkollën e Lartë Pedagogjike, degën e letërsisë në Shkup. Nga viti 1946 punoi mësues në Tërrnoc të Bujanocit dhe më pas në shkollën fillore "Liria" të Shkupit. Për kontributin në arsim u nderua me çmimin "Pishtar i Arsimit". Më 1971, kur doli numri i parë i gazetës arsimore-pedagogjike "Shkëndija" në Prishtinë, zgjidhet redaktor e më pas zëvendëskryeredaktor i saj, ndërkaq në vitin 1980 kryeredaktor. Këtë detyrë e ushtroi deri më 1987, kur u pensionua. Ka shkruar komente, vështrime e analiza nga fusha e arsimit dhe e pedagogjisë. Ishte edhe kryetar i Seksionit të Gazetave Arsimore të ish-Jugosllavisë. (Zenun Çelaj)

SELIMI Musa (1968-). Trajner, mësimdhënës universitar. Lindi në Bresalc të Gjilanit. Nga viti 2002 punon në Fakultetin e Shkencave Sportive të Universitetit të Prishtinës, fillimisht si asistent në lëndën e voleybollit, kurse në vitin 2004 mori gradën doktor i shkencave të kulturës fizike dhe sportit dhe avancoi edhe në tituj e tjerë universitarë. Para se të niste karrierën universitare, në vitin 1994 u bë trajner, fillimisht në voleyboll. Në vitin 1997 u emërua trajner i skuadrës së "Gjilanit", ndërsa në vitin 2003 drejtoi ekipin e voleybollit të meshkujve "Drita" po në Gjilan. Në vitin 2000 fitoi Kupën dhe Superkupën e Kosovës. Në vitin 2008 mori drejtimin e Federatës së Voleybollit të Kosovës, kurse një vit më vonë u emërua edhe nënkryetar i Komitetit Olimpik të Kosovës. Përveç "Gjilanit", në futboll udhëhoqi edhe skuadrat "Drita" e "Ferronikeli". (Tahir Sopi)

SELIMI Qerim (1963-). Biolog, profesor universiteti. Lindi në fshatin Vërnice të Vushtrisë. Shkollimin fillor dhe të mesëm i kreu në vendlindje, ndërsa studimet për biologji i kreu në Universitetin e Prishtinës (UP) në vitin 1989. Studimet pasuniversitare i vazhdoi në Universitetin e Sarajevës, ndërsa tezën e doktoratës e mbrojti po në UP (2002). Është

avancuar në të gjithë titujt universitarë për lëndët fiziologji krahasuese dhe mbrojtje të mjedisit. Ka publikuar disa punime shkencore në revista të ndryshme brenda dhe jashtë vendit dhe ka marrë pjesë në disa konferenca shkencore. (Zahadin Shemsedini)

SELIMI Rexhep (1971-). Njëri nga theme-luesit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), bashkëluftëtar i Adem Jasharit, anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së. Lindi në Açarëvë të



REXHEP SELIMI

Skënderajt. Pas shkollës së mesme në Klinë, kreu studimet në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës, degën e letërsisë dhe gjuhës shqipe. Si nxënës dhe student mori pjesë aktivisht në demonstratat e vitit 1989-1990. Në periudhën 1990-1993 u përfshi në aktivitetin e Lëvizjes Popullore për Republikën e Kosovës. Më 1993 nisi angazhimet për organizimin e luftës së armatosur. Mori pjesë në organizimin dhe kryerjen e shumicës së aksioneve të UÇK-së, që nga aksionet e para të armatosura. Në tetor të vitit 1996, për shkak të aktivitetit në kuadër të UÇK-së, u dënua në mungesë nga gjykata serbe e Prishtinës me 20 vjet burg. Që nga ajo periudhë kaloi në arrati dhe aktivitetin e zhvilloi kryesisht në Prekaz dhe në gjithë Drenicën, pastaj në Dushkajë dhe Dukagjin. Përveç me A. Jasharin në Drenicë, koordinoi veprimet luftarake edhe me Z. Pajazitin në Llap, me L. Haradinaj në Dukagjin, me L. Brahimajn në Dushkajë dhe me M. Zymberin në Rahovec. Ishte i përfshirë në strukturat udhëheqëse të UÇK-së që nga fillimi, në Shtabin Operativ dhe në Shtabin e Përgjithshëm. Së bashku me D. Haradinaj dhe M. Krasniqin ishte treshja e parë që më 28 nëntor 1997, në fshatin Llaushë të Skënderajt bënte paraqitjen e parë publike si pjesëtarë të UÇK-së në varrimin e mësuesit Halit Geci. Në periudhën prill-nëntor 1998, në fazën e riorganizimit të UÇK-së dhe të Shtabit të Përgjithshëm, mori udhëheqjen e drejtorisë operative në SHP të UÇK-së, duke u marrë me themelimin dhe strukturimin e njëjësive të rregullta të UÇK-së. Nga nëntori i vitit 1998 mori detyrën e inspektorit të përgjithshëm të UÇK-së, detyrë që e ushtroi deri në përfundim të luftës. Një kohën e Qeverisë së Përkohshme

të Kosovës u emërua ministër i Rendit Publik dhe më pas ishte angazhuar në Trupat Mbrojtëse të Kosovës (TMK). Më 2003 u demobilizua nga TMK-ja dhe iu kthye jetës civile. Në zgjedhjet e vitit 2010 dhe 2014 mori mandatin e deputetit të Kuvendit të Kosovës si pjesë e Lëvizjes “Vetëvendosje”. (Mihait Reçi)

SELIMI Selim (1916-1995). Aktivist i Partisë Komuniste të Jugosllavisë. Lindi në Preshevë. Shkollën fillore e kreu në Preshevë. Në Shkup mbaroi Medresën e Madhe. Fakultetin Juridik e kreu në Beograd. Aktivitetin politik e fillon në vitin 1938, me themelimin e celulës së parë partiake në Preshevë, në bashkëpunim me Komitetin Krahinor të PKJ-së për Maqedoni. Ishte anëtar i Komitetit lokal të PKJ-së në Preshevë. Në shtator të vitit 1943 fashistët bullgarë ia pushkatojnë familjen, ndërsa ai burgoset. Pas ikjes nga burgu, vendoset në Gjilan, ku vazhdon aktivitetin ilegal. Ishte anëtar i Komitetit të Rrethit të Gjilanit. Kah fundi i vitit 1943 i bashkohet aradheve partizane. Nga shtatori i vitit 1944 bëhet anëtar i kryesisë së Këshillit Nacionalclirimtar të Rrethit të Preshevës, më vonë sekretar i Komitetit të Rrethit të Preshevës. Pas vitit 1947 kalon me punë në Beograd. Gjatë viteve 1967-69 ishte deputet në Dhomën Ekonomike të Serbisë nga rrethi i Preshevës. Vdiq në Beograd. (Irir Zylfiu)

SELIMI Sylejman (1970-). Komandant i Përgjithshëm i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), komandant i Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK) dhe komandant i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK). Lindi në Aqarevë të Skënderajt. Pas shkollës së mesme ndoqi studimet në Fakultetin e Metalurgjisë në Mitrovicë. Pas luftës vazhdoi studimet për drejtësi dhe kreu një sërë kualifikimesh nga fusha e sigurisë dhe



SYLEJMAN SELIMI

e mbrojtjes në Gjermani, në Turqi dhe vende të tjera. Është njëri ndër themeluesit e UÇK-së. Mori pjesë në organizimin dhe kryerjen e shumicës së aksioneve luftarake të UÇK-së. Në tetor të vitit 1996 kaloi në ilegalitet, bashkë me M. Krasniqin, R. Selimin dhe Xh. Gashin, duke përqendruar aktivitetin kryesisht në Prekaz, në Aqarevë, Jabllanicë etj. Në vitet 1998 ishte

komandant i Zonës Operative të UÇK-së në Drenicë, ndërsa më pas u emërua komandant i Përgjithshëm i UÇK-së. Pas përfundimit të luftës dhe transformimit të UÇK-së në TKM, S. Selimi mori detyrën e komandantit të Gardës së Kosovës (1999-2000), ndërsa gjatë viteve 2000-2006 ishte zëvendëskomandant i TMK-së, më pas komandant i TMK-së (2006-2009). Gjatë viteve 2009-2011 ishte edhe komandant i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK). Në periudhën 2012-2016 ishte ambasador i Republikës së Kosovës në Shqipëri. U nderua me mirënjohje dhe dekorata të shumta për merita të veçanta për çlirimin e Kosovës. (Sylë Ukshini)

SELIMI-BLAKÇORI Qamile (1954-). Gazetare. Lindi në Nesalc të komunës së Bujanocit. Shkollimin fillor e mbaroi në Prishtinë, ndërkaq atë të mesëm në SHBA. U diplomua për gazetari në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës (1979). Po atë vit zuri punë në redaksinë e gazetës së përditshme “Rilindja” dhe 20 vjet punoi gazetare-redaktore në rubrikën e politikës së jashtme. Gjatë kësaj periudhe ka ndjekur si reportere ngjarjet aktuale politike në botë dhe në rajonin e Ballkanit. Është autore e një sërë shkrimesh dhe analizash mbi çështjet e ndryshme ndërkombëtare. (Nehat Islami)

SELIMI-OSMANI Edibe (1952-). Mbledhëse dhe studiuese e folklorit. Lindi në Gostivar. Ka mbaruar studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin Filologjik në Shkup. Është marrë me mbledhjen dhe studimin e lirikës popullore, gojëdhënave, riteve dhe besimeve popullore në vise të ndryshme ndër shqiptarët e Maqedonisë. Ka botuar këto vepra: “Lirika popullore në trevat e Tetovës dhe të Gostivarit” (1993), “Rite e besime popullore në viset e Tetovës dhe të Gostivarit” I, II (1997, 2007), “Gojëdhënat dhe besimet për qyqen” (2000), “Gjarpri në mitologjinë popullore të shqiptarët e Maqedonisë” (2005), “Simbole vendëse ilire të shqiptarët e Maqedonisë” (2011), “Veshja autoktone e femrave të Rekës së Epërme” (2012) dhe “Veshja autoktone e meshkujve të Rekës së Epërme” (2014). (Zymer U. Neziri)

SELISHÇEV A. M. (Seliščev) (1886-1942). Gjuhëtar rus. Studioi sllavistikë në Universitetin e Kazanjit. Ishte profesor universiteti në Irkutsk (1918-1920), pastaj në Kazanj dhe në Moskë. Njihet si specialist i gjuhëve sllave.

Shkroi edhe për gjuhët e Ballkanit, hulumtoi për origjinën e sllavëve dhe gjithashtu është marrë me studimin e raporteve ndërmjet shqipes dhe gjuhëve sllave të jugut. Disa nga veprat e Selishçevit janë: “Hyrje në gramatikën e krahasuar të gjuhëve sllave” (Vvedenie v sravnitel’nuju grammatiku slavjanskih jazykov, 1914), “Gjuhësia sllave: gjuhët sllave perëndimore” (Slavjanskoe jazykoznanie: zapadnoslavjanskije jazyki, 1941) etj. Vepra e tij “Vendosja sllave në Shqipëri” (Slavjanskoe naselenie v Albanii, 1931) ka rëndësi për studimin e ndikimeve sllave në gjuhën shqipe. (Agnesa Hasimja)

SELMANAJ Selman (1943-). Ekonomist, profesor universitar. Lindi në fshatin Restovë të komunës së Deçanit. Shkollën fillore e mbaroi në vendlindje, ndërsa shkollën e mesme ekonomike në Gjilan. Studimet për ekonomi i kreu në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës (1967), studimet pasuniversitare i kreu në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Beogradit, ndërsa doktoroi në Fakultetin Ekonomik të



SELMAN
SELMANAJ

Universitetit të Zagrebit (1979). Në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës filloi të punojë që nga viti 1967 e deri në pensionim në vitin 2008, si profesor i lëndëve: sistemet ekonomike bashkëkohore, makroekonomia, ekonomia e transicionit etj. Po ashtu ligjëroi në Fakultetin e Shkencave Aplikative të Biznesit në Pejë, në Universitetin e Tetovës dhe në Universitetin e Europës Juglindore në Tetovë. Gjatë kësaj periudhe publikoi një numër punimesh shkencore dhe profesionale brenda dhe jashtë vendit, si dhe është autor i disa teksteve universitare (“Sistemet ekonomike bashkëkohore”, “Globalizimi dhe transicioni”, “Globalizimi dhe ndërtimi i shtetit” etj.). Përveç punës pedagogjike dhe shkencore, kreu edhe punë udhëheqëse në institucione të ndryshme të vendit: ka qenë dekan dhe prodekan i Fakultetit Ekonomik, drejtor i Entit për Kërkime Ekonomike në Fakultetin Ekonomik, kryeredaktor i revistës “Ekonomia” etj. (Myrvete Badivuku-Pantina)

SELMANI Ahmet (1965-). Shkrimtar, gazetar, përkthyes. Lindi në Gllumovë të Shkupit. Kreu shkollën fillore në vendlindje, të mesmen në

Shkup, studimet për letërsi në Universitetin e Prishtinës. Është autor studimesh dhe kritikash letrare, që janë botuar në revista dhe gazeta të ndryshme. Disa vjet ka punuar si gazetar, redaktor i botimeve, komentator dhe kryeredaktor në gazetën “Flaka”. Ka botuar librat: “Poezia dhe individualiteti” (studim, 1996), “Tregu i djallëzisë” (tregime, 1998), “Bashkëbiseduesit e mi” (biseda me shkrimtarë, 2000), “Mur i gjallë” (poezi, 2005), “Diskurs kritik” (ese, kritikë, studime, 2005), “Abeja e akullit” (poezi, 2009), “Hija e kalit” (roman, 2010), “Bërja e shkretëtirës” (roman, 2014) etj. Ka përkthyer veprat e disa autorëve nga kroatishtja e serbishtja dhe anasjelltas. (Salajdin Salihu)

SELMANI Naim (1981-). Gazetar i sportit. Lindi në Prishtinë. Shkollën fillore e kreu në Fushë Kosovë, ndërsa të mesmen në Prishtinë. Në vitin 1999, krahas shkollimit, filloi punën si asistent gjuhësor me trupat e KFOR-it në Kosovë. Më pas u punësua në Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë. Ndërkohë kreu studimet për gazetari dhe më 2009 u punësua si gazetar sporti në televizionin “Klan Kosova”. (Edmond Thaçi)

SEMINARI NDËRKOMBËTAR PËR GJUHËN, LETËRSINË DHE KULTURËN SHQIPTARE. Institucion i themeluar në Fakultetin e Filologjisë (atëherë Filozofik) të Universitetit të Prishtinës, për të promovuar gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare në botë. Nisi nga puna më 1974 me emrin Qendra e Gjuhës Shqipe për të Huaj, për t’u pagëzuar një vit më pas me emrin që e mban edhe sot. Drejtori i parë i Seminarit ishte Idriz Ajeti, ndërsa sekretar i parë Rexhep Ismajli. Mbahet në Prishtinë, ndonëse në vitet ’70 të shek. XX është mbajtur edhe në Pejë, Brezovicë dhe Prizren. Pjesa më e madhe e albanologëve më të shquar botërorë (joshqiptarë) kanë qenë pjesë e Seminarit, qoftë si studentë që e kanë mësuar shqipen, qoftë si pjesëmarrës me kumtesa, referime e ligjërata. Në mesin e tyre mund të përmenden: Francesco Solano, Erik Hemp, Anja Desnickaja, Irena Savicka, Robert Elsi, Norbert Borecki, Viktor Fridman, Brajan Xhozef, Oliver Shmid, Françesko Altimari, Italo Fortino, Aleksandar Rusakov, Ishtvan Shyc etj. Seminari ka pasur disa ndërprerje. Puna e tij u ndalua më 1981, për shkak të demonstratave në Kosovë. Është

ndalur gjithashtu në periudhën 1991-1995, kur masat serbe kanë paralizuar institucionet e Kosovës. Seminari për dy vjet është bartur në Tiranë (1995 dhe 1996), por trazirat e vitit 1997 atje pamundësuan vazhdimin e punës. Seminari u rikthyer në Prishtinë në vitin 2000, pas luftës së vitit 1999 dhe nuk ka pasur më ndërprerje pune. Sesionet 19 dhe 20 (2000-2001), sikur edhe ata të viteve 1996 dhe 1997, janë organizuar në bashkëpunim me Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Pas kësaj organizohen në bashkëpunim me Fakultetin e Histori-Filologjisë të Universitetit të Tiranës. Si forma pune ka kurset e gjuhës shqipe për të huajt në nivele të ndryshme, referimet dhe ligjëratat, si dhe sesionet shkencore. Sesionet shkencore për letërsi dhe gjuhë (në atë të fundit edhe për kulturë) mbahen dy ditët e fundit të Seminarit. Çdo vit ka tema të ndryshme bosht të sesioneve shkencore. Punimet e çdo Seminari përmbledhen dhe botohen në vëllime të veçanta, që konsiderohen ndër revistat më autoritative të albanologjisë në botë. Çdo vit marrin pjesë rreth njëqind seminaristë të vendeve të ndryshme, përfshirë: SHBA-në, Rusinë, Kinën, Japoninë, Sirinë, Jordaninë, Gjermaninë, Zvicrën, Francën, Rumaninë, Bullgarinë, Italinë, Poloninë, Serbinë, Maqedoninë, Greqinë, Kroacinë, Çekinë, Hungarinë, Austrinë, Kosta-Rikën etj. Seminari ka pasur rëndësi, duke u konsideruar shkollë verore për mësimin e shqipes, si forum shkencor elit i albanologjisë dhe për krijimin e kontakteve me qendra të ndryshme studimore në botë. (Bardh Rugova)

SEMINARI ORTODOKS I PRIZRENIT. Shkollë për përgatitjen e klerikëve ortodoksë serbë. Është i vendosur në qendër të Prizrenit. Njihet edhe si “Prizrenska Bogosllavija”. U themelua në vitin 1870 nga Sima Andrejeviq-Igumanov. Njëri nga udhëheqësit e këtij seminari ishte edhe Petar Kostiq, konsull serb, në kohën e të cilit ky seminar u kthye në qendër të propagandës serbe. Në vitin 1965 kishte 400 nxënës. Pas përfundimit të luftës së fundit në Kosovë, një pjesë e komunitetit serb të Prizrenit u strehua në objektet e këtij seminari. Nga viti 2004, pas ngjarjeve të marsit të këtij viti, seminari u zhvendos në qytetin e Nishit, prej nga vazhdon propagandën antishqiptare. (Alban Dobruna)

SERBIA. Shtet në Gadishullin Ballkanik, me sipërfaqe 77,453 km² dhe me 7,186,862 banorë. Kryeqytet është Beogradi. Është njëra nga 6 republikat e ish-Jugosllavisë. Serbia shtrihet



BEOGRADI

në pjesën qendrore të Europës Juglindore, në kontaktin e Gadishullit Ballkanik me fushën e Panonisë. Në veri kufizohet me Hungarinë, në verilindje me Rumaninë, në lindje me Bullgarinë, në jug me Kosovën dhe Maqedoninë, në jugperëndim me Malin e Zi, në perëndim me Bosnjën dhe Hercegovinën dhe në veriperëndim me Kroacinë. Në veri të Danubit shtrihet fusha e Vojvodinës, ndërsa në jug të kësaj vije ndarëse shtrihen këto tërësi: Sremi, Shumadia, Sanxhaku, Serbia Lindore dhe Serbia Jugore. Serbia nuk ka dalje në det dhe në kohën e ish-Jugosllavisë lidhjet me dete i realizonte përmes territorit të republikave të tjera. Shpërbërja e ish-Jugosllavisë e shndërron Serbinë në një shtet me pozitë kontinentale. Megjithatë, luginat lumore të drejtimit meridional dhe transversal i japin territorit të Serbisë atributet e pozitës transite. Nëpër luginën e Moravës kalon boshti kryesor meridional ballkanik, nëpër të cilin është ndërtuar arteria kryesore rrugore e Gadishullit Ballkanik, Korridori X. Përmes grykës së Siçevës ajo komunikon me Bullgarinë në lindje, ndërsa përmes magjistrales së Ibrit, lidhet me Malin e Zi dhe komunikon me magjistralen e Adriatikut. Përfundimi i ndërtimit të “Rrugës së Kombit” nëpër territorin e Kosovës deri në Merdar i mundëson Serbisë që të lidhet më shpejt me Kosovën dhe bregdetin shqiptar. Dendësia mesatare e popullsisë në Serbi është rreth 100 banorë në 1 km². Koncentrimi më i madh i popullsisë është në Beograd dhe në luginën e Moravës, ku dendësia arrin deri në 130 b/km². Në strukturën etnike të popullsisë,

përveç serbëve me 6 milionë banorë (2011) ose 83.3%, jetojnë edhe hungarezët me 253,900 banorë (3.5%), shqiptarët me rreth 100,000 banorë rezidentë, kryesisht në Luginën e Preshevës, pastaj romët, boshnjakët, rumunët, bullgarët, sllovakët, etj. Në variablat kyçe demografike kriza vazhdon të thellohet deri në shkallë të tendencave ekstreme negative. Potenciali biologjik i tyre është reduktuar aq shumë sa që edhe njëra edhe tjetra kanë hyrë në fazën e procesit të shpopullimit të shpejtuar, si pasojë e rënies së natalitetit, shtimit natyror negativ dhe rënies së numrit të përgjithshëm të popullsisë, proces që në demografi njihet si denatalitet. Popullsia e Serbisë ka shtim natyror negativ. Kjo situatë dominon sidomos në Serbinë Lindore dhe në Vojvodinë. Shkallët më të larta të mortalitetit se sa të natalitetit janë reflektuar në zvogëlimin e numrit të përgjithshëm të popullsisë prej rreth 300,000 banorëve gjatë periudhës 2002-2011. Një ecuri e tillë demografike është kushtëzuar nga disa faktorë socioekonomikë, sociopsikologjikë dhe arsimorë, por edhe konfliktet dhe luftërat në Kroaci, Bosnjë dhe në Kosovë, ku Serbia ishte drejtpërdrejt e implikuar. Pasojat e regresit në zhvillimin demografik të Serbisë deridiku relativizohen nga imigrimi i disa qindra mijëra refugjatëve serbë prej republikave tjera të ish-Jugosllavisë. Për t'i realizuar qëllimet hegemoniste për dominim në Gadishullin Ballkanik, Serbia në vitet '90 të shekullit të kaluar nxiti konflikte dhe luftëra në Kroaci, Bosnjë e Hercegovinë dhe së fundmi në Kosovë. Të gjitha luftërat kishin për qëllim grabitjen e territoreve të republikave fqinje. Vrasjet e njerëzve dhe dëbimet e dhunshme të kryera nga policia dhe ushtria serbe kishin për qëllim spastrimin etnik të këtyre territoreve dhe ndryshimin e kompozicionit etniko-demografik.

Baza e volitshme natyrore-gjeografike ofron kushte të mira për zhvillimin ekonomik. Mirëpo zhvillimet politike dhe luftërat në vitet '90, të cilat Serbia i zhvilloi në Gadishullin Ballkanik shkaktuan izolimin politik dhe ekonomik të saj, që pati për pasojë ngecjen në zhvillim. Bujqësia realizon 16.6% të brutoprodhimit shoqëror, industria me 25.5% dhe veprimtaritë shërbyese me 57.9%. Kushtet natyrore janë të volitshme për zhvillimin e bujqësisë. Sipërfaqja e tokave bujqësore është 5,734,000 ha (0.56 ha/b). Rajoni kryesor bujqësor është Vojvodina (hambari i Serbisë) ku mbillet gruri, misri, luledielli,

panxharsheqeri etj. Bujqësia është zhvilluar edhe në fushën e Leskocit, në Shumadi, në luginën e Moravës etj. Industria disponon një bazë energjetike të mjaftueshme nga eksploatimi i thëngjillit, hidroenergjisë, naftës dhe gazit natyror. Është zhvilluar industria e rëndë, ajo e makinave dhe e automobilave (Kragujevc), e pajisjeve për hekurudha, industria petrokimike (Pançevë), metalurgjia me ngjyra (Bor), e përpunimit të drurit. etj. Këmbimi i jashtëm tregtar i Serbisë në vitin 2007 ishte 19,79 miliardë dollarë; ai realizohet kryesisht me vendet e Europës Perëndimore (60%), me vendet e rajonit, Rusinë etj. Qendra kryesore politike, ekonomike, administrative, kulturore dhe universitare është Beogradi. Qendrat e tjera të mëdha rajonale janë: Novi-Sadi, Nishi, Kragujevci etj. (Hivzi Islami)

SERBISHTJA. I takon grupit të gjuhëve sllave. Flitet në Serbi (ekavishtja), në Mal të Zi (ijekavishtja), në Sanxhak, në një pjesë të Bosnjës dhe Hercegovinës, në Kroaci (ijekavishtja). Serbishtja e Kosovës është pjesë e tërësisë dialektore të serbishtes dhe i përket dialektit të ekavishtes me dy nënndarje kryesore: në Kosovën Veriore flitet dialekti "kosovsko-resavski", ndërsa në pjesët juglindore dialekti i njohur si "prizrensko-južnomoravski" (ose "prizrensko-timočki") e disa e shohin si dialekt torllak, ku përfshihen të folme të kufirit Kosovë-Maqedoni, Serbi-Maqedoni dhe Serbi-Bullgari. Të folmet juglindore serbe kanë më shumë tipare ballkanike. Serbishtja hyn në gjuhët sintetike-analitike. Sistemi grafik i gjuhës së sotme serbe-shkrimi cirilik i ka 30 grafema njërrrokëshe dhe i përgjigjet sistemit fonologjik të gjuhës së sotme. I ka katër lloje të theksit: theksin e gjatë zbritës, theksin e gjatë ngjites, theksin e shkurtër zbritës dhe theksin e shkurtër ngjites. Në sistemin e fjalëve veçohen dy lloje funksionale: njërin e përbëjnë fjalët që ndërtojnë grupin emëror ose fjalinë: emrat dhe përemrat emërorë, fjalët që ndërtojnë fjalinë, foljet; fjalët që nuk e ndërtojnë as grupin emëror as fjalinë, fjalët me funksion parësor adverbial: ndajfoljet dhe ndajfoljet përemërore; fjalët me funksion parësor atributiv: mbiemrat dhe mbiemrat përemërorë dhe fjalët me funksion kryesisht gramatikor: parafjalët, lidhëzat, pasthirmat dhe pjesëzat. I ka tri gjini emërore: gjininë mashkullore, femërore dhe asnjansë; shtatë rasa: emëroren gjinoren dhanoren, kallëzoren,

thirroren, instrumentalin dhe vendoren. Dallon nga bullgarishtja dhe maqedonishtja, të cilat nuk e kanë ruajtur kategorinë e rasës, kurse nga gjuhët e tjera sllave serbishtja më shumë e ka ruajtur rasën thirrrore. Në sistemin e rasave funksion të rëndësishëm morfosintaksor kanë parafjalët. Si edhe në shumicën e gjuhëve sllave, përveç bullgarishtes e maqedonishtes, parafjalët pak a shumë u janë nënshtruar ndërtimeve analitike të rasës. Përjashtim bën sinkretizmi i rrjedhores dhe gjinore dhe përdorimi i ndërtimeve analitike me parafjalën *od /prej, nga/* në rasën gjinore. Deri në shek. XVII serbët e kanë përdorur sllavishten e vjetër, në shek. XVIII gjuhën ruso-sllave, përkatësisht sllavishten e lashtë, kurse nga gjysma e shek. XVIII gjuhën sllavo-serbe, përzierje e gjuhës popullore dhe ruso-sllave. Me reformën e Vuk Karaxhiqit, gjuha letrare serbe është bërë gjuhë popullore (dialekti i ijekavishtes), i cili pastaj është zëvendësuar me dialekt të ekavishtes, duke e zëvendësuar diftongun *ie* me zanoren *e*. Sipas autorëve kroatë, nga fundi i shek. XIX deri në fund të shek. XX kanë vazhduar “aspiratat e përafrimit të gjuhës serbe dhe kroate (në të cilën janë fshehur idetë serbomëdha), por kjo ide asnjëherë nuk ka mundur të zbatohet deri në fund”. (Naile Mala-Imami)

SERBIZMAT. Fjalë ose shprehje të gjuhës serbe, të cilat i ka marrë ndonjë gjuhë tjetër. Para serbizmave, gjuha shqipe i ka huazuar fjalët nga sllavishtja e vjetër dhe sllavishtja kishtarë, për shembull (*i dobët nga oudobv* (i mirë, i rehatshëm), gozhdë nga *gvozdb*, oborr nga *obor* (gardh), sheleg nga *seletak* etj. Nga gjuha serbe shqipja ka huazuar më së shumti në kohën e sundimit të perandorit Dushan. Ka huazime sllave në terminologjinë bujqësore: *bagëti* nga *bogatb* (i pasur), *blegtor* nga *blâgo* (visar, pasuri, bagëti), *grabujë* nga *grabulja*, *lopatë* nga *lopata*, *kosit* nga *kositi*, *prashit* nga *oprašiti* etj. Edhe nga disa fusha të tjera ka huazime serbe/sllave: *buj* nga *buditi* (zgjohem), *bujar* nga *boljar* (fisnik), çerdhe nga *çerda* (kope, tufë), çudit nga *çuditi*, krahinë nga *krajina*, e përzier me fjalën shqipe *krah* etj. Gjuha shqipe ka një numër prapashtesash nga gjuha serbe : *-ac, -aç, -ajkë, -ak, -an, -anak, -ash, -ashkë, -avë, -avët, -avec, -çe, -çinë, -dhë* (nga *-da*), *-icë, -ik, -iç(ë), -ishë, -ishtë* etj. (Naile Mala-Imami)

SEREMBE Zef (1844-1901). Poet arbëresh. Lindi në Stringhar (San Cosmo Albanese), fshat arbëresh në krahinën e Kalabrisë, në Itali. Nxënës i De Radës në Kolegjin e Shën



ZEF SEREMBE

Adrianit, në moshën 14 vjeçare, për shkak të fatkeqësive familjare e shëndetit të lig detyrohet të lërë studimet që nuk do t'i rimarrë më. Dënimi e më pas vdekja e parakohshme e të atit dhe ungjit do të shenjojnë fillimin e rrënimit

ekonomik të familjes, që do ta shoqërojë gjithë jetën bashkë me trazimet dashurore. Më 1874, pas vitesh shtegtimi nëpër vise të ndryshme të Italisë e ngulimeve arbëreshe, emigron në Brazil, për një fillim të ri, i rekomanduar në oborin e perandorit Pedro II nga Dora d'Istria, me kujtimin e gjallë të së dashurës që kish emigruar e ndërruar jetë po atje. Vetëm një vit më vonë, pas zhgënjimesh dashurore dhe të tjera, i dëshpëruar deri në tentativë vetëvrasjeje, merr udhën e kthimit në vendlindje. Peripecitë e ndjekin, në kthim e plaçkitin në Marsejë, ku humbet edhe pjesën më të madhe të dorëshkrimeve. Më 1895 kthehet sërish përtejdetit, në SHBA e më pas në Argentinë e Brazil, ku gjendet i vdekur më 1901.

Në të gjallë botoi: “Zonjës Madhe Perëndesh Elenes Gjika” (1870); “Poezi italisht dhe këngë origjinale përkthyer prej shqipes” (Poesie italiane e canti originali tradotti dall’albanese, Kozenza 1883) që përmban 32 poezi të përkthyer nga arbërishtja në italisht dhe 5 poezi në italisht; “Këngëz mali, në Arbri i ri” (Palermo 1887); “Tingëllima të ndryshme” (Sonetti vari, Napoli 1890-1?); “Kthimi i ushtarit” (Il reduce soldato, Cordigliano 1893, Rossano 1894, Nju-Jork 1895); “Zotit” (A Dio, Buenos Aires 1897), variant i përpunuar i të parit botuar në “Poesie italiane...”; “Pietro Iriani - Odë shqiptare” (A Pietro Irianni - Ode albanese, në “La Nuova Albania, Napoli 1898) dhe “Flamuri shqiptar” (La bandiera albanese, Napoli 1899). Pas vdekjes botohet nga i nipi Cosmo Serembe përmbledhja “Vjershe” (Milano, 1926); “Dorëshkrime”, transkriptuar nga Dh. Shuteriqi në revistën “Nëntori” në vitin 1974. Pas botimeve kritike të G. Gradilonës (1986, 1989), botimet kritike

të veprës së plotë të Z. Serembes janë të V. Belmonte: "Omaggio a Giuseppe Serembe" (1988), "Alla ricerca del Serembe autentico" (1991) dhe "Canti" (2007). Nga letërkëmbimi i Serembes me De Radën e Kamardën dhe të dhëna të tjera bibliografike mbi të hetohet se kanë humbur rreth 200,000 vargje të poemës "Njeriu në skenën e Gjithësisë dhe në praninë e Zotit", përkthime të "Psallmeve të Davidit" dhe një "Histori e Shqipërisë".

Z. Serembe poet e identifikon poezinë me lirikën si gjini personale e universale, këndon për veten duke e themeluar si subjekt lirik, për vashën, atdheun dhe natyrën, në kërkim të dëshpëruar të Zotit dhe të harmonisë hyjnore ("Shën Mërisë së papërlyer", "Shën Mërisë virgjër", "Kryqi", "Zotit", "Shën Kozmait e Shën Damianit", "Natë"), të së bukurës, së mirës e së vërtetës. Vetmia dhe melankolia bëhen kusht, të më dhe gjendje e përhershme krijimi; natyra, pasqyrë e shpirtit ("Tufani", "Jeta", "Te bregu i detit"), koha tirane ("Elegji", "Zonjës Lule", "Një ditë është jeta", "Kujtimi", "Urim"); dashuria, shpëtim prej një bote perfide të paaftë ta kuptojë, dhimbje e kujtim që jetohej si ëndërr e fantazi ("Vrull", "Fytyra e saj", "Vashës së largët", "Këngëtari dhe bilbili" etj.). (Dhurata Shehri)

SERMAXHAJ Myderriz Haki (1914-1948). Titullar i fesë islame. Lindi në Hogosht të Kamenicës, ku mori mësimet e para fetare. Kreu Medresenë "Medah" (1940) në Shkup. Po atë vit u kthye në Gjilan si myderriz i Medresesë "Atik" dhe drejtor i saj. U angazhua për reformimin e medresesë dhe futi në programin mësimor gjuhën shqipe si lëndë mësimi. Pas Luftës së Dytë Botërore u përfshi në organizimin politik të Lëvizjes Nacional-Demokratike Shqiptare (NDSH) dhe "Besa Kombëtare". Ishte në krye të komitetit të qarkut të NDSH-së për rrethin e Gjilanit. Pas zbulimit dhe burgosjes së anëtarëve të komitetit të qarkut të NDSH-së në Shkup, në gusht të vitit 1946 u arrestua edhe H. Sermaxhaj. Nga torturat në burg sëmuret rëndë, ndërkohë që Gjyqi i Qarkut në Gjilan e dënoi me 20 vjet heqje lirie. Për vuajtjen e dënimit u dërgua në burgun e Mitrovicës së Sremit, ku vdiq më 1948 dhe u varros në varrezat e burgut. (Qemajl Morina)

SERSEM Ali Dede (?-1569). Poet, vezir, kryegjysh bektashi. Lindi në Tetovë në një familje feudale vendëse. Ishte njeri me dije dhe

me kulturë të gjerë. Gjatë kohës së mbretërimit të sulltan Sylejmanit Ligjdhënës (1520-1566), Aliu arriti gradën e vezirit dhe u mbiquajt Server Ali pasha. Motra e tij, princesha Mahidevran ishte gruaja e sulltan Sylejmanit dhe nëna e princ Mustafait. Biografët e paraqesin si vezir të aftë dhe të shkathët, por të dhënë shumë pas misticizmit islam. Në vitin 1562 me vetëdëshirë hoqi dorë nga grada e vezirit dhe me leje të sulltan Sylejmanit shkoi në teqenë e Haxhi Bektashit, ku zuri postin e kryegjyshit. Nga pasuria e tij u ndërtua teqeja bektashiane në Tetovë, e cila u quajt Teqeja e Sersem Ali Babës. Kjo teqe u rinovua dhe u zgjerua me objekte përcjellëse nga Rexhep Pashë Tetova në kohën kur në postin e babait ishte Mehmed Harabati Baba (vdiq më 1780), prandaj sot njihet me emrin Teqeja e Harabati Babës dhe është ndër më të bukurat dhe më të mëdhatë në Ballkan. Sersem Ali Dedeja ka qenë poet i frytshëm mistik. Disa nga poezitë e tij janë botuar të përkthyer në gjuhën shqipe. (Nehat Krasniqi)

SERREÇI Matej (1928-1972). Aktor. Lindi në Ferizaj. Kreu aktrimin në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prishtinë. Në Teatrin Popullor Krahinor (TPK), me ndërprerje të kohëpaskohshme, u angazhua që nga viti 1949. Gjatë viteve '50 dhe '60 realizoi dhjetëra role në shfaqje të ndryshme nga dramaturgjia kombëtare dhe ajo botërore. Shfaqjet, ku luajti rolet më të spikatura janë: "Për kafshatën e bukës"



MATEJ SERREÇI

(1952), "Zonja ministreshë" (1957) etj., ndërsa luajti edhe në shfaqjet: "Personi i dyshimtë" (1949), "Vjedulla para gjyqit" (1950), "Pushteti" (1950), "Zhelanët" (1950), "Zjarri dhe hiri" (1950), "Zullumqari" (1951), "Për kafshatën e bukës" (1952), "Martesa" (1952), "Sikur të isha djalë", (1952), "Oda e errët" (1956), "Kunora" (1967), "Fosilet" (1968), "Othello" (1968), "Duart e papastra" (1968), "Mbreti Edip" (1970) etj. (Arian Krasniqi)

SERREÇI Gjon (1920-1947). Ideolog dhe njëri nga themeluesit e Lëvizjes Nacional-Demokratike Shqiptare (LNDSH), luftëtar për çlirim dhe bashkim kombëtar. Lindi në Ferizaj. Kreu seminarin ipeshkvnor në Prizren, më pas



GJON SERREQI

filloi studimet e larta për filozofi në Zagreb (1941), që i vazhdoi në Pizë (1941) dhe Firenze të Italisë (1941-1943). Më 1943 u emërua kryetar komune në Babush të Ferizajt. Në maj të vitit 1944 u arrestua nga Gestapoja dhe u dërgua në kampin e Prishtinës, e më pas në një kamp të Vjenës, nga ku u lirua në maj të vitit 1945. Pas kthimit nga internimi, u emërua mësimdhënës në gjimnazin e Prishtinës (qershor 1945). Nuk u pajtua me rikthimin e pushtetit të Jugosllavisë në Kosovë dhe as me politikën që zbatonte pushteti jugosllav ndaj shqiptarëve. Ishte njëri ndër ideologët dhe themeluesit e LNDSH-së. Në shtator të vitit 1945 iu përkushtua plotësisht LNDSH-së, duke u bërë njëra nga figurat qendrore të saj në Rrafshin e Kosovës, të Anamoravës dhe të Karadakut. Në prill të vitit 1946, për t'i shpëtuar burgosjes, u detyrua të kalojë në ilegalitet, duke iu bashkuar njësiteve të armatosura, që vepronin në terren. Më pas iu bashkua shtabit të zonës së dytë të LNDSH-së, duke marrë edhe postin e sekretarit të shtabit. Me insistimin e tij u formua Komiteti i Rinisë së LNDSH-së për rrethin e Ferizajt. Ishte njëri ndër organizatorët dhe ideatorët e Kongresit V të LNDSH-së, që u mbajt në Blinajë të Lipjanit, që njihet si Kongresi i Lipovicës (25 korrik 1946). Më pas, për t'i shpëtuar ndjekjeve të reparteve të UDB-ës, kaloi në viset e Ferizajt, në Kopilakë, në Luboten dhe më pas në rajonin e Anamoravës. Në regionin e gjerë të Kamenicës rifunksionalizoi dhe ngriti komitetin e LNDSH-së dhe njëherësh organizoi komitetin e qarkut në Tërnoc të Bujonocit (1946). Në shkurt të vitit 1947 u arrestua, u dënua me vdekje nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë dhe u pushkatua. (Skënder Lutfiu).

SFERKA. Fshat në komunën e Klinës, 17 km në jug të saj. Shtrihet në lartësi mbidetare 650 m. Sipërfaqja e territorit të fshatit është 1,594 ha, nga e cila pjesën dërrmuese të sipërfaqes (60%) e zënë arat. Në vitin 2011 kishte 2,448 banorë, ndaj 761 banorëve në vitin 1948. Është vendbanim i tipit të grumbulluar. Popullsia merret me bujqësi, blegtori, tregti etj. Nga objektet e standardit shoqëror ka shkollën 9-vjeçare, stacionin shëndetësor dhe disa njësi

tregtare. Është bashkësi lokale, në të cilën gravitojnë vendbanimet: Sferkë, Dush i Vogël, Perçevë, Volljakë, Çupevë e Ulët dhe Çupevë e Epërme. (Ferim Gashi)

SIDA/AIDS. Është infeksion i shkaktuar nga virusi i imunodeficiencës humane HIV. Në stadin fillestar sëmundja karakterizohet me simptome të ngjashme të gripit, ku për një periudhë të gjatë mungojnë shenjat karakteristike të infeksionit. Me përparimin e sëmundjes dhe futjen e virusit në sistemin imunitar, simptomat më tepër gjasojnë në tuberkuloz, infeksione të tjera oportune dhe tumore, të cilat normalisht nuk paraqiten te personat me sistem imunitar të paprekur. Simptomat e mëvonshme të infeksionit referohen sikur SIDA. Sëmundja SIDA në stad të zhvilluar komplikohet me infeksion të mushkërive (pneumocystis pneumonia), humbje peshe, karcinomë (Kaposi sarcoma) etj. Rrugë kryesore e përhapjes së infeksionit HIV është marrëdhënia seksuale e pasigurt, transfuzioni i gjakut nga persona të infektuar, gjilpëra nënlëkurore dhe nga nëna te fëmija (gjatë shtatzënisë, gjatë lindjes apo gjidhënie). Nga viti 1981, kur edhe u njoh si sëmundje, deri në vitin 2012, AIDS ka shkaktuar vdekjen e 36 milionë njerëzve, ndërsa 35,3 milionë aktualisht janë të infektuar me virusin HIV. Kosova bën pjesë në shtetet me numër të ulët të rasteve të sëmundjes, por me tendencë të lartë për shtim të rasteve. Rastet e para të kësaj sëmundjeje në Kosovë janë regjistruar në vitin 1986 dhe deri në vitin 2014 janë regjistruar 97 raste, me 40 vdekje. Gjinia mashkullore është më tepër e prekur nga sëmundja, kryesisht të moshës më aktive, 25-34 vjeç. (Ismë Humolli)

SIFILIZI. (*Syphilis-Luesi*). Është sëmundje ngjitëse sistemike me dekurs kronik, i cili gjatë zhvillimit dhe përparimit imiton gati të gjitha sëmundjet që njih mjekësia. Prek të gjithë organet e njeriut, sidomos lëkurën, sistemin nervor qendror, eshtrat, organet gjenitale etj. Sifilizi shkaktohet nga spiroheta *Treponema Pallidum*, që është parazit anaerob dhe shumë i ndjeshëm në ambientin e jashtëm. Pas periudhës së inkubacionit prej 3 javësh (sillet prej 10 ditë deri në 3 muaj), fillojnë simptomat e sëmundjes që zhvillohen në 3 faza. Personi është i infektuar, derisa janë të pranishme lezionet në lëkurë dhe mukoza që zgjat disa javë apo muaj të tërë. Sifilizi

bartet nga nëna në fryt, duke shkaktuar sifilizin kongjenital. Rreziku i bartjes së infeksionit është 60-80%, varësisht nga mosha e frytit në kohën e infeksionit të nënës. Shkaktari i sëmundjes është shumë i ndjeshëm në penicilinë, prandaj është preparat parësor për mjekimin e sifilizit. Sëmundja kryesisht bartet me rrugë seksuale, por edhe me rrugë të tjera, sidomos përmes transfuzionit të gjakut të infektuar. Sifilizi erdhi në Europë nga marinarët e Kolombos dhe që në shek. XV shënohen epidemitë e para të kësaj sëmundjeje në Itali. Epidemitë kishin karakter të lokalizuar. Në Kosovë sifilizi endemik ka qenë i pranishëm në Rrafshin e Dukagjinit, por është eliminuar pas fushatave antisifilitike. Sot numri i rasteve të sëmundjes është jashtëzakonisht i ulët dhe shfaqet në formë sporadike. Shkalla e përhapjes së sëmundjes ka tendencë rritjeje në kushte të jashtëzakonshme dhe si pasojë e promiskuitetit, narkomanisë, alkoolizmit, higjienës së ulët etj. (Isme Humolli)

SIGURIMET SHOQËRORE. Nënkuptojnë sigurimin zyrtar të të moshuarve, të kujdestarëve dhe të të paaftëve, përfshirë edhe sigurimin e tyre shëndetësor. Të përfshirët në këtë sistem, si punëdhënësit si të punësuarit, gjatë periudhës sa punojnë paguajnë një përqindje të caktuar të pagës së tyre në formën e kontributit, qoftë për sigurim pensional ose për sigurim shëndetësor. Në Kosovë tani për tani funksionon vetëm sigurimi pensional, në të cilin gjysma e kontributit paguhet nga punëdhënësi dhe gjysma tjetër nga i punësuarit. Me daljen në pension, të punësuarit e përfshirë në këtë skemë kanë të drejtë të marrin përfitimet, që janë të bazuara në kontributet e tyre. Sigurimet shoqërore gjithashtu sigurojnë përfitime për punëtorët e paaftë dhe për personat në varësi dhe ata që përkujdesen për ta. Aktualisht, të gjithë ata që punojnë janë të mbrojtur ose nga sigurimet shoqërore, ose nga programe të tjera qeveritare. Megjithatë, në Kosovë ende nuk janë zhvilluar skemat e sigurimit shëndetësor dhe kjo bën që qytetarët e Kosovës të mos kenë qasje në shërbime më cilësore shëndetësore. (Drita Kongjeli)

SIJARINA Ismet (1975-). Regjisor, mësimdhënës. Lindi në Prishtinë, ku mbaroi arsimin fillor dhe të mesëm. Kreu studimet për regji filmi në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës (1996). Bëri regjinë e filmave tele-

vizivë “Kulshedra” (2005), “Rekrutimi” (2006) dhe “Muret” (2012), të filmit të metrazhit të gjatë “Ama dorën” (2008), si dhe të filmit dokumentar “Përtej ylberit” (2007). Nga viti 2006 punon si mësimdhënës i regjisë së filmit në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. Është themelues i studios për prodhimin e filmit “Thumbs Up” dhe i organizatës “Go Green Kosovo”. (Erson Zymberi)

SIJARINA. Vendbanim rural në komunën e Medvegjës, rreth 12 km në juglindje të qendrës. Është ngritur në rrafshin e vjetër liqenor, në pjesën e sipërme të pellgut të lumit të Banjskës. Është vendbanim i tipit të shpërndarë, i cili shtrihet në lartësi mbidetare 500-930 m. Në vitin 1948 në Sijarinë jetonin 984 banorë, ndërsa në vitin 2002 ishin regjistruar vetëm 415 banorë. Sijarina dhe fshatrat e tjera të Jabllanicës (komuna e Medvegjës) janë përfshirë nga valët intensive të shpopullimit, me tendencë të shuarjes së plotë. Në fshatin Sijarinë, sikurse edhe në Tupallë, Svircë, Ramabajë, Banjë të Sijarinës dhe Kapit ka jetuar një numër i konsiderueshëm i banorëve shqiptarë. Terreni kodrinor-malor, pozita kufitare me Kosovën dhe përqendrimi i forcave të shumta policore dhe ushtarake serbe në këto anë kanë detyruar popullsinë shqiptare të shpërngulet në drejtim të Kosovës dhe gjetiu. (Arsim Ejupi)

SILAJXHIQ Haris (1945-). Historian, politikan dhe diplomat boshnjak. Lindi në Breza pranë Visokos (Bosnjë). Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa të mesmen në Sarajevë.



HARIS SILAJXHIQ

U diplomua për gjuhë arabe dhe studime islame në Bengazi (Libi). Magjistroi me temën mbi shtypin e Bosnjës dhe Hercegovinës për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit (1977). Tezën e doktoratës me titull “Qëndrimi i SHBA ndaj çështjes shqiptare ndërmjet dy luftërave botërore” e mbrojti në Universitetin e Prishtinës (1979). Në vitin 1974 filloi punë në Institutin e Historisë në Prishtinë, kurse më 1978 zgjidhet mësimdhënës i orientalistikës në Universitetin e Prishtinës. Nga viti 1996 është profesor në Fakultetin e Filozofisë në Sarajevë dhe që nga viti 1998 dhe në “Cornell University Ithaca” të

Nju-Jorkut. Në periudhën 1991-1993 ai ishte ministër i jashtëm i Republikës së Bosnjës dhe Hercegovinës dhe nga 1993-1996 kryeministër. Në vitin 1996 u largua nga Partia e Aksionit Demokratik e A. Izetbegoviqit dhe themeloi Partinë për Bosnjë dhe Hercegovinë, me të cilën hyri në Asambleenë Parlamentare të Bosnjës dhe Hercegovinës dhe u bë njëra nga partitë kryesore boshnjake. Ishte anëtar i delegacionit boshnjak, i cili negocioi Marrëveshjen e Dejtonit. Vazhdon të jetë figurë e rëndësishme në politikën e Bosnjës dhe Hercegovinës. (Jusuf Bajraktari)

SIMNICA Ismail (1953-). Inxhinier i makinerisë. Lindi në Lajthishtë të Obiliqit. Shkollën fillore e kreu në fshatin Hade, ndërsa shkollën e mesme dhe Fakultetin Teknik në Prishtinë. Fillimisht u punësua në kombinatin “Kosova” në Obiliq (1971), më pas punoi në disa shkolla të mesme teknike, por prapë u kthye në Termocentralin “Kosova A” (1981). Në fillim punoi si inxhinier kryesor në procesin e prodhimit të energjisë elektrike, më vonë udhëheqës i prodhimit (1999-2004) dhe, së fundi, inxhinier kryesor për trajnime teknologjike (2012). Është autor i librit profesional-shkencor “Doracak termoenergetik” (2006) dhe i disa udhëzuesve për mënyrën e shfrytëzimit dhe mirëmbajtjen e pajisjeve në TEC. Është autor edhe i disa veprave letrare. (Fejzullah Krasniqi)

SINA Iljaz (1935-). Trajner i futbollit. Lindi në Gjakovë. Shkollimin fillor e kreu në vendlindje, Normalen e nisi në Gjakovë dhe e përfundoi në Prishtinë. Kreu studimet në Fakultetin e Kulturës Fizike në Beograd, specializoi në futboll dhe mori titullin e trajnerit të kategorisë së parë. Sina e kishte nisur karrierën si hendbollist i KH “Normalisti” nga Prishtina (1953 -1955), ndërsa më pas u bë trajner i kësaj skuadre. Ishte lojtar dhe trajner i Vëllaznimit, duke arritur ta bënte këtë skuadër katër herë kampion të Kosovës dhe pjesëtar të ligës së dytë të ish-Jugosllavisë (1972/73). Më vonë ishte trajner dhe vëzhgues i shtabit profesional të Lidhjes Futbollistike të ish-Jugosllavisë. E drejtoi për një kohë shkollën e futbollit të “Prishtinës” dhe ishte në krye edhe të skuadrave të tjera kosovare, si “Flamurtari”, “Ramiz Sadiku” dhe “Besëlidhja”, ndërsa ishte edhe ndihmëstrajner i përfaqësueses së Kosovës dhe udhëheqës i shkollës së futbollit

në “Edirnespor” në Turqi (1993-1994). (Moral Pozhegu)

SINAGOGA E HEBRENJVE NË PRISHTINË. Sinagoga e hebrenjve në Prishtinë u ndërtua në vitin 1897. U rrënua pas ardhjes së komunistëve në pushtet, me pretekstin e



SINAGOGA E PRISHTINËS

ndërtimit socialist të vendit, gjatë procesit të zbatimit të planit të ri urbanistik për qytetin e Prishtinës (1960). Sinagoga ishte në hyrje të Kuvendit të Kosovës, apo në vendin ku tashmë është vendosur memoriali për viktimat hebraike të holokaustit në maj të vitit 2013. Sinagoga u rrënua, ashtu siç u rrënuan edhe objektet e tjera të rëndësishme të trashëgimisë kulturore dhe fetare të strukturës së vjetër urbane të qytetit, siç ishte Xhamia njohur e Llokaçit, në vend të së cilës u ndërtua Teatri Krahinor i Kosovës, ndërsa në vend të Kishës Katolike u ndërtua shtëpia e vjetër e mallrave “Gërmia”, përfshirë edhe çarshinë e vjetër të qytetit. (Qemajl Morina)

SINANAJ Zekë (1957-). Gazetar. Lindi në Isniq të Deçanit. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, gjimnazin në Deçan, kurse Fakultetin Juridik në Universitetin e Prishtinës. Në fillim bashkëpunoi me gazetën “Rilindja”, kurse nga viti 1985 punoi si gazetar në Radiotelevizionin e Prishtinës, në emisionin “Kronika e Prishtinës”. Pas mbylljes së dhunshme të RTP-së më 1990 bashkëpunoi me gazeta dhe revista, si “Gazeta shqiptare”, “Kombi” etj. Gjatë viteve ’90 u angazhua në komisionin për informim të komunës së Deçanit, kurse gjatë viteve 1998-99 raportoi nga zonat e luftës për programin për Kosovën të Televizionit Shqiptar. Në

Radiotelevizionin e Kosovës (RTK) realizoi dokumentarë të shumtë nga lufta dhe jeta sociale. Është redaktor në RTK. (Shaqir Foniqi)

SINANI Shaban (1956-). Gazetar i sportit. Lindi në fshatin Sëllarcë e Epërme të Tetovës. Karrierën si gazetar i sportit e nisi në të përditshmen e Shkupit “Fakti” në vitin 1998. Krahas kësaj, punoi edhe në “TV Art” të Tetovës, pastaj në portalin “Yllpress.com” në redaksinë në gjuhën shqipe të Radio-Shkupit dhe në gazetën sportive në gjuhën maqedonase, në gazetën “Sporti shqiptar” të Tiranës dhe “Kosova sport” e Prishtinës etj. Njëkohësisht ishte bashkëthemelues i disa klubeve sportive të shqiptarëve në Maqedoni, pastaj ushtri edhe funksione të ndryshme në Federatën e Futbollit të Maqedonisë, në Federatën e Atletikës të Maqedonisë etj. Ka botuar libra nga fusha e sportit (“Sporti shqiptar në vitë”, “15 vjet të KF ‘Flamurtari’, “30 vjet të KF ‘Shkëndija’” etj.). (Xhavit Kajtazi)

SINANI Shefqet (1955-). Futbollist, trajner. Lindi në Prishtinë. Nisi karrierën prej futbollisti te KF “Fushë Kosova” dhe e vazhdoi më pas te KF “Flamurtari”. Njihet si futbollist i “brezit të artë” të “Prishtinës”, kur skuadra bënte gara në ligën e parë federative të ish-Jugosllavisë. Gjatë periudhës 1991-1998 u angazhua për pavarësimin e sportit të Kosovës, duke dhënë kontribut në riorganizimin e KF “Prishtina”. Kreu punën e trajnerit te grupmoshat e reja të KF “Prishtina”, derisa më herët kishte drejtuar edhe skuadrat si “Besëlidhja” dhe “Flamurtari” të Prishtinës dhe “Besa” e Pejës. Vijoi shkollën për trajner në UEFA “B”. (Ejup Llumnica)

SINANI Tahir (1964-2001). Dëshmor i kombit, luftëtar i tri luftërave çlirimtare. Lindi në Gri të Tropojës. Shkollën e mesme e kreu në Tropojë. Kreu shkollën ushtarake dhe më 1986 u emërua instruktor i stërvitjes në divizionin ushtarak të Bajram Currit. Më vonë u emërua shef i sektorit për intervenime të shpejta. Me fillimin e luftës në Kosovë u emërua oficer në kampin e stërvitjes të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) në Tropojë. Në nëntor të vitit 1998 kaloi në Pashtrik dhe u emërua anëtar i Shtabit të UÇK-së dhe më pas komandoi njësinë speciale të Shtabit të Përgjithshëm. Iu besua detyra e instruktorit të stërvitjes. Pas fillimit të sulmeve të NATO-së kundër forcave

serbe, iu ngarkua detyra për mbrojtjen e Zonës Operative të Pashtrikut. Më 12 qershor 1999 me ushtarët e tij hyri fitues në Prizren. Pas transformimit të UÇK-së në Trupat Mbrojtëse të Kosovës (TMK), u emërua komandant i Qendrës së Doktrinës dhe Strëvitjes në Nashec. Si pjesëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Preshevës, Medvegjës e Bujanocit (UÇPMB) luftoi në Konçul, Dobrosin, Bujanoc. Pas çmobilizimit të UÇPMB-së, iu bashkua Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare dhe u emërua komandant i Brigadës 116, me qendër në Tanushë të Gostivarit. U vra më 29 korrik 2001. Më 2002 trupi i tij u rivarros në Varrezat e Dëshmorëve në Landovicë të Prizrenit. (Fehari Ramadani)

SINELLA Fehmi (1923-). Veprimtar i arsimit. Lindi në Kavajë, ku kreu edhe shkollën fillore. Arsimin e mesëm e mori në Medresenë dhe në Liceun real të Tiranës. Në vitin 1948 u diplomua për mësues. Ishte njëri nga mësuesit nga Shqipëria, të cilët erdhën në Kosovë në vitin 1945. Punën e mësimit e filloi në vitin shkollor 1945/46 në Hogosht të Kamenicës, pastaj në Zym, përkatësisht në Carallukë të Malishevës, në Vushtrri, në fshatra të Lushnjës dhe të Rogozhinës. Ishte edhe inspektor arsimit në Rahovec, kryeredaktor i revistës “Pionieri”, bashkëpunëtor i disa revistave në Shqipëri dhe në Kosovë, autor i disa veprave: “E bardha e mund të zezën”, “Kur më kur?” (2011) etj. F. Sinella është bartës i disa mirënjohjeve dhe dekoratave, ndër të cilat edhe i medaljes “Naim Frashëri”, akorduar nga shteti shqiptar. (Bajram Shatri)

SINODI I KISHËS ORTODOKSE SERBE. Autoriteti më i lartë ekzekutiv dhe gjyqësor i Kishës Ortodokse Serbe. Udhëhiqet nga patriarku, pjesë e të cilit janë edhe katër peshkopë të zgjedhur nga Kuvendi i Shenjtë i Kishës. Të zgjedhurit kanë mandat dyvjeçar dhe çdo vit zgjidhen dy anëtarë të rinj dhe dy anëtarë si zëvendës. Përmes Sinodit të Shenjtë, Kisha Serbe ruan unitetin dogmatik dhe kanunor, si dhe lidhjen e vazhdueshme me të gjitha kishat autoqefale. Si trup gjyqësor, Sinodi i Shenjtë gjykon në instancë të parë mosmarrëveshjet midis peshkopëve, fajësimet kanonore të peshkopëve dhe fajësimet zyrtare disiplinore të organeve të veta. Sinodi, nën udhëheqjen e patriarkut, në takimin urgjent dhe të zakonshëm thërret Kuvendin e Shenjtë.

Sinodi merr vendimet unanimsisht apo me shumicë votash. Në rast se ka ndarje të votave, vendos vota e presidentit. (Qemajl Morina)

SINOIMERI Mufit (1924-1955). Mësues. Lindi në Gjirokastrë, ku kreu edhe shkollën filllore, më pas kreu Normalen e Elbasanit. Gjatë viteve 1941-1943 ishte mësues në shkollën filllore në fshatin Poroj të Tetovës, pastaj në fshatin Zhitoshë të Prilepit dhe në disa fshatra në rrethin e Strugës dhe të Kërçovës. U mor edhe me poezi, të cilat i botoi në revistën “Jeta e re” dhe në shtypin e kohës. (Hatixhe Vojka-Ismajl)

SIPARUNTI. Vendbanim i periudhës romake, i cili përmendet nga Ptolemeu (“Gjeografia”). Ubifikimi i saktë i vendbanimit vazhdon të jetë i diskutueshëm në mesin e studiueseve. Në mesin e hipotezave, spikat ajo e ubifikimit me mbetjet e vendbanimit të periudhës romake në fushën e Pejës (kompleksi i fabrikës së baterive dhe areali i saj), i cili shtrihet në të dyja anët e lumit Bistricë. (Emine Kalaja-Hajdari)

SIQECA Shpresë (1952-). Etnologe. Lindi në Mitrovicë. Kreu shkollimin në Prizren, ndërsa studimet e larta për etnologji në Universitetin e Beogradit. Studimet pasuniversitare për letërsi i mbaroi në Universitetin e Prishtinës. Për një kohë të gjatë ka punuar në Qendrën Rajonale të Trashëgimisë Kulturore në Prizren dhe, në kuadër të saj, në Komplexin Monumental të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit si bashkëpunëtorë e pavarur për etnologji. Në vitet 2002-2012 ka punuar si ligjëruese në Universitetin e Prishtinës, në departamentin e etnologjisë të Fakultetit Filozofik. Ka botuar katër libra nga fusha e trashëgimisë kulturore: “Veshjet kombëtare shqiptare në periudhën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (thesare të kulturës popullore në kompleksin monumental të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit)” (1998), “Perlat e etnisë shqiptare në Prizren” (2002), “Arkitektura folklorike e Prizrenit dhe e Malishevës” (2011), “Arkitektura folklorike e rajonit të Prizrenit në shekujt XVIII-XIX” (2011). Ka botuar dhe një sërë artikujsh studimorë dhe ka marrë pjesë në kongrese, konferenca dhe simpoziume të etnografëve brenda dhe jashtë vendit. Është kryeredaktore e gazetave “Etno-art” dhe “Gruaja në fokus”. Ka hapur disa ekspozita në Prizren dhe Prishtinë dhe ka marrë pjesë në panaire të artizanaleve në Kosovë dhe jashtë saj. Bashkëpunon me

institucione të ndryshme shkencore që merren me trashëgiminë kulturore dhe etnografike. (Bashkim Lajçi)

SIRINIQI. Trevë në juglindje të Rrafshit të Kosovës, shtrihet ndërmjet maleve të Nerodimes, Zharit, Jezercit, Oshlakut dhe Sharrit, përgjatë rrjedhës së lumit Lepenc. Përmes grykës së Brodit lidhet me Rrafshin e Kosovës, kurse përmes qafës së Prevallës dhe kanionit të Lumëbardhit të Prizrenit lidhet me Rrafshin e Dukagjinit. Siriniqui ndërtohet nga formacionet e vjetra të paleozoikut dhe ato të rejtat të kuaternarit në rrafshin aluvial të Lepecit. Përbën një fushëgropë malore me lartësi të madhe mbidetare, ku vërehen gjurmët e relievit akullnajor. Temperaturat mesatare të janarit arrijnë deri -2.8°C, kurse të korrikut deri 18°C. Sasia mesatare e reshjeve arrin 1,000 mm. Peizazhin e dominojnë pyjet dhe kullotat. Siriniquin e përbëjnë 16 vendbanime, tetë të banuara me serbë e malazezë, katër me shqiptarë dhe pesë të tjera me popullsi të përzier. Qendra kryesore është Shtërpca. Popullsia merret kryesisht me blegtori dhe turizëm. Në Brezovicë është ngritur qendra turistike e skijimit dhe e rekreacionit. (Selim Qevani)

SISTEMET E UJITJES. Duke marrë për bazë klimën, tokën dhe bimësinë, territori i Republikës së Kosovës është i ndarë në dy zona agroekologjike: Rrafshi i Dukagjinit dhe



UJITJA NGA SISTEMI “IBËR-LEPENC”

Rrafshi i Kosovës. Dokumentet e para për ujitje datojnë nga shek. II e.s. Dokumentet me shkrim nga fillimi i shek. XIV janë gjetur në Manastirin e Deçanit, që dëshmojnë për traditën e vjetër të ujitjes në Kosovë. Rregullat e ujitjes sanksionoheshin edhe në Kanunin e Lekë Dukagjinit. Edhe gjatë sundimit të Perandorisë Osmane kishte kanale të ujitjes. Deficiti i reshjeve prej 350-400 mm gjatë verës imponon ujitjen në trevat e Kosovës.

Ujitja në Kosovë ndahet në tri periudha. Periudha e parë përfshin kohën deri në vitin 1925. Ujiteshin sipërfaqet përreth rrjedhave ujore. Sipërfaqet e përgjithshme ujitëse kanë qenë rreth 30,000 ha, kanalet kanë qenë të thelluara në tokë dhe të ndërtuara nga vetë bujqit. Periudha e dytë përfshin vitet 1925-1944. Në vitin 1925 formohet seksioni i drejtorisë së përgjithshme të ujërave të Ministrisë së Ndërtimit të Serbisë në Pejë. U hartuan edhe projektet e përgjithshme për ujitjen e tokave të pjesës veriore dhe jugore të Rrafshit të Dukagjinit, kryesisht të sipërfaqeve të rrafshëta (për kolonë). Prodhimtaria bimore ngelet e njëjtë. Periudha e tretë filloi me ndërtimin e sistemit të parë në territorin e Rogovës, me kanal kryesor dhe kanaleta të betonuara. Ky sistem ujiste 1,300 ha. Vendzënia e ujit ka qenë në Drinin e Bardhë, nën Urën e Fshejtë, ndërsa sistemi i parë për ujitje në formë shiu u ndërtua në fushën e Prizrenit (1962) me sipërfaqe prej 5,000 ha. Uji merrej nga Bistrica e Prizrenit. Ndërmjet viteve 1963-1970 u ndërtuan edhe 10 sisteme të tjera për ujitje në sipërfaqe prej 16,957 ha, kryesisht në pjesën veriore të Dukagjinit. Kështu, në vitin 1970 në Rrafshin e Dukagjinit kishte 51,465 ha nën ujitje. Në pjesën qendrore dhe lindore të Kosovës ujitja bëhej me përmasa shumë të vogla (500-600 ha), përreth lumenjve të Sitnicës, Moravës së Binçës dhe degëve të tyre, si dhe nga ujërat nëntokësore (puset), maksimalisht deri 1,000 ha.

Nga viti 1973 filloi ndërtimi i dy sistemeve të mëdha: në pjesën lindore të Kosovës ai i "Ibër-Lepencit", përkatësisht i fazë së parë, Hidrosistemi "Ibri" në sipërfaqe prej 20,000 ha, me ujitje në formë shiu, si dhe në Rrafshin e Dukagjinit ai i "Radoniqit" në 10,250 ha, që u lëshuan në funksionim të plotë më 1985. Kështu, në këtë periudhë, Kosova kishte rreth 80,000 ha nën sisteme të ujitjes ose 20% të sipërfaqeve bujqësore, që u zvogëluan në 70,000 ha me ndërtime urbane. Deri tani janë

ndërtuar 6 akumulime me rreth 555 milionë m³/vit. Në bazë të parametrave të llogaritur, krahasuar me vëllimin e prodhimtarisë së përgjithshme bujqësore pa ujitje dhe me ujitje është fituar herësi i rritjes për 3.4 herë.

Gjatë viteve 1991-99 u zvogëluan sipërfaqet e ujitura nga 70,000 ha në më pak se 20,000 ha, e posaçërisht gjatë periudhës së luftës (1999), sistemet e ujitjes u ndërprejnë së funksionuari. Pas luftës mund të shfrytëzoheshin për ujitje vetëm rreth 20,000 ha (në kuadër të sistemeve të vjetra). Që nga maji i vitit 2001 Agjencia Europiane për Rindërtim (EAR), si dhe një agjenci holandeze (DRA) financuan projektin për rehabilitimin e sistemeve të ujit për tërë Kosovën. Aktualisht, përmes tri sistemeve rajonale mund të ujitën rreth 55,000-60,000 ha. Është parashikuar ndërtimi i sistemeve të reja të ujitjes, bazuar në akumulimet e reja dhe në burimet e ujërave nëntokësore, të cilat do të mundësonin ujitjen e sipërfaqeve prej 170,000-200,000 ha. (Bashkim Kabashi)

SISTEMI BANKAR. Bankat janë institucione financiare, aktiviteti kryesor i të cilave është ndërmjetësimi financiar. Pra, aktiviteti kryesor i bankave është ndërmjetësimi financiar ndërmjet depozituesve dhe kredimarrësve. Bankat ofrojnë edhe shërbime të tjera financiare, siç janë shërbimet e pagesave, shërbimet e konsulentit financiar etj. Sistemi bankar i Kosovës përbëhet nga 10 banka komerciale, prej të cilave tetë janë në pronësi të huaj dhe dy janë në pronësi vendore. Bankat e huaja në Kosovë menaxhojnë rreth 90% të aseteve të sistemit bankar. Aktiviteti kryesor i bankave në Kosovë është kredidhënia, e cila kryesisht financohet nga depozitat e mbledhura brenda vendit. Në vitin 2014 kreditë përfaqësonin 59.1% të aseteve të sektorit bankar, përderisa depozitat përfaqësonin 79.6% të detyrimeve. Sistemi bankar i Kosovës karakterizohet nga shkalla e lartë e qëndrueshmërisë, e cila shprehet me shkallë të lartë të kapitalizimit dhe të likuiditetit, si dhe cilësi të mirë të portofolit kreditor. (Arben Mustafa)

SISTEMI ENERGETIK. Është tërësia e burimeve të energjisë të të gjitha llojeve dhe e mënyrave për sigurimin (nxjerrjen), konvertimin, shpërndarjen dhe përdorimin e tyre, si dhe sistemet e pajisjeve dhe komplekset organizative që furnizojnë konsumatorët me

të gjitha produktet e energjisë. Elementet e sistemit energjetik janë rrjetet e sistemeve elektroenergjetike dhe të furnizimit me ngrohje; sistemet e industrisë së qymyrit dhe sistemet e furnizimit me naftë dhe gaz natyror, përfshirë edhe stabilimentet e konsumatorëve. Sistemi elektroenergjetik i Kosovës bën pjesë në sektorin e energjisë dhe është në përgjegjësi të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik (MZHE). Institucionet e tjera me përgjegjësi të caktuara janë edhe Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE), Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM) dhe të disa ministrive të tjera. Organizimi dhe menaxhimi i sektorit të energjisë bazohet në kornizën ligjore të këtij sektori.

Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) është ndërmarrja kryesore e sistemit elektroenergjetik të Kosovës, me termocentralet “Kosova A” dhe “Kosova B” me fuqi të instaluar prej 1,478 MW. Hidrocentralet me kapacitet të instaluar prej 47 MW nuk janë në kuadër të KEK-ut. Termocentrali “Kosova e Re” me fuqi prej 600 MW është në fazën e kontraktimit dhe gjithashtu do të jetë jashtë KEK-ut. Aktualisht thëngjilli, linjiti, nxirret në minierën e Sibofcit Jugperëndimor (rreth 9 milionë tonë në vit) dhe kryesisht shërben për prodhimin e energjisë elektrike në termocentrale. Sasi të vogla të linjtit shkojnë në industri dhe në treg si lëndë djegëse. Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe i Tregut (KOSTT) operon me rrjetin e transmisionit të energjisë elektrike në Kosovë dhe është i lidhur me sistemet e shteteve fqinje. Përbëhet nga linjat e tensionit të lartë (400 kV, 220 kV dhe 110 kV) me gjatësi 1,197 km dhe me fuqi bartëse prej 1,550 MW. Fuqia e tërësishme transformimit të nënstacioneve është 4,880 MVA. Kompania Kosovare e Distribucionit dhe e Furnizimit me Energji Elektrike (KEDS) operon me rrjetin e shpërndarjes, që përfshin rrjetin e tensionit të mesëm (35 kV, 10 kV dhe 6 kV), rrjetin e tensionit të ulët (0.4 kV) së bashku me nënstacionet përkatëse, si dhe grupet matëse, njehsorët individualë të konsumatorëve. Ngrohja qendrore sigurohet nga ngrohoret e qyteteve (Prishtinë, Gjakovë, Mitrovicë dhe Zveçan). Me projektin e kogjenerimit “Termokosi” i Prishtinës furnizohet nga Termocentrali “Kosova B” me kapacitet nominal prej 140 MW. Fuqia e instaluar e ngrohjes mbulon vetëm 5% të nevojave të Prishtinës. Në Kosovë nuk ka infrastrukturë

të gazit natyror, përveç një rrjeti të vjetër të gazit me gjatësi prej 254 km, nga gazifikimi i linjtit në ish-Elektroekonominë e Kosovës. Infrastruktura e gazit natyror parashihet të lidhet me Unazën e Gazit të Komunitetit të Energjisë, që lidh shtetet e Europës Juglindore, përfshirë dhe Kosovën, si dhe me projektin e gazsjellësit TAP (Trans-Adriatik-Pipeline). Të gjitha karburantet e lëngëta (derivatet e naftës dhe gazi natyror i lëngëzuar) importohen. Ministria e Tregtisë dhe e Industrisë është përgjegjëse për rregullimin administrativ dhe tregtimin e tyre. Kapaciteti aktual i depove për karburante është rreth 80,000 m³, ndërsa q i pikave të shitjes me pakicë rreth 40,000 m³. Planifikimi, dizajnimi, ndërtimi, mirëmbajtja dhe eksploatimi i sistemit energjetik duhet të bëhet me kujdesin më të madh për shfrytëzim racional, rritje të efikasitetit dhe mbrojtje të mjedisit. (Ali Hamiti)

SISTEMI I PENSIONEVE. Rregullon pagesën e pensioneve, të një shume të caktuar parash, e cila u paguhet rregullisht personave që kalojnë një moshë apo arrijnë përvojë të caktuar pune, të shprehur me vitet e punës, ose kur humbin aftësinë e punës. Në Republikën e Kosovës sistemi i pensioneve përfshin tri kategori. Pensionet e kategorisë së parë përfshijnë pensionin minimal të rregullt mujor për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, të cilët i kanë mbushur 65 vjet; pensionet për qytetarët e punësuar në Republikën e Kosovës, të cilët i kanë paguar kontributet në ish-Fondin Pensional të Kosovës para datës 1 janar 1999; pensioni për paaftësinë e përhershme, të cilët i plotësojnë kriteret e parapara me ligj; pensioni i parakohshëm, që është pensioni i rregullt mujor i paguar për minatorët e kompleksit “Trepça” dhe minatorëve të tjerë të punësuar në minierat e tjera të Kosovës, të cilët i plotësojnë kriteret e parapara me ligj; pensioni invalidor i punës, që u paguhet personave që pësojnë lëndime në punë apo fitojnë sëmundje profesionale gjatë marrëdhënies së punës, të cilët i plotësojnë kriteret e parapara me ligj; pensioni familjar, që është pensioni i rregullt mujor i paguar për anëtarët e familjes, në rast të vdekjes së të punësuarit, që ka qenë në marrëdhënie pune dhe që i plotësojnë kriteret e parapara me këtë ligj. Për dallim nga kategoria e parë, kategoria e dytë mbështetet në kursime të personave që janë në marrëdhënie pune

ose janë të vetëpunësuar. Ata janë të obliguar të kontribuojnë në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës. Në momentin e pagesës së parë, secilit pjesëmarrës i krijohet një llogari e re në këtë Fond (e bazuar në numrin unik individual), në të cilën pjesëmarrësi vazhdon të kontribuojë gjatë tërë periudhës së punësimit, deri në momentin e pensionimit. Në kategorinë e tretë hyjnë skemat pensionale joobliguese, të cilat licencohen dhe krijohen sipas ligjit si dhe organizohen si fonde plotësuese pensionale të punëdhënësit, sikundër edhe fondet plotësuese individuale të pensionit, që krijohen nga personat fizikë apo institucionet financiare të licencuara për të ushtruar këtë aktivitet. (Ymer Havolli)

SISTEMI ZGJEDHOR I KOSOVËS. Pas rrënimit të autonomisë nga fillimi i viteve '90 të shekullit të kaluar, në Kosovë u krijua një sistem zgjedhor i pavarur nga Serbia. Zgjedhjet



NJË VENDVOTIM

e para të pavarura u mbajtën më 24 maj 1992, me çrast u zgjodh presidenti dhe deputetët e Kuvendit të Kosovës. Me sistem të kombinuar (mazhoritar dhe proporcional), 100 nga 130 deputetë u zgjodhën sipas sistemit mazhoritar dhe 30 të tjerë sipas atij proporcional. Zgjedhjet e dyta presidenciale dhe parlamentare u mbajtën më 22 mars 1998 sipas sistemit të njëjtë zgjedhor. Pas përfundimit të luftës në Kosovë, OSBE-ja brenda UNMIK-ut krijoi një sistem të veçantë zgjedhor për Kosovën. Më 28 tetor 2000 u organizuan zgjedhjet e para lokale për zgjedhjen e kuvendeve komunale, me sistemin proporcional, me lista të hapura, ku secila komunë ishte një zonë zgjedhore. Më vonë, mbështetur në Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisjen në Kosovë, në

vitin 2001 u mbajtën zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, ku 20 prej 120 ulëseve ishin të rezervuara për komunitetet joshumicë. Në këto zgjedhje u aplikua sistemi proporcional me lista të mbyllura, ku i tërë territori i Kosovës konsiderohej si një zonë e vetme zgjedhore. Edhe zgjedhjet lokale të vitit 2002 u mbajtën sipas sistemit proporcional. Në vitin 2004 u mbajtën zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, kurse në vitin 2007 u organizuan zgjedhjet e përbashkëta (për Kuvendin e Kosovës dhe zgjedhjet lokale për kryetarë të komunave dhe për kuvendet komunale). Risi për këto zgjedhje ishte përcaktimi i pragut zgjedhor prej 5% për Kuvendin e Kosovës dhe hapja e listave. Nga zgjedhjet e vitit 2007, në Kosovë filloi të aplikohet sistemi proporcional zgjedhor, me lista të hapura me më shumë kandidatë. Ndërkaq, ndryshimi në zgjedhjet lokale, ishte zgjedhja e kryetarit të komunës me votë të drejtpërdrejtë, nga më shumë kandidatë.

Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, bazuar në Ligjin për zgjedhjet e përgjithshme dhe Ligjit për zgjedhjet lokale, u mbajtën dy palë zgjedhje lokale dhe dy palë zgjedhje të përgjithshme. Zgjedhjet e para lokale në Kosovën e pavarur u mbajtën më 15 nëntor 2009, gati pa asnjë ndryshim nga zgjedhjet e vitit 2007 dhe të tilla do të mbahen edhe në vitin 2013. Ndërkaq, zgjedhjet parlamentare të vitit 2010 dhe ato të vitit 2014 u organizuan sipas sistemit të njëjtë proporcional me lista të hapura, me Kosovën si një zonë e vetme zgjedhore. Sipas sistemit zgjedhor në fuqi, Kosova konsiderohet një zonë zgjedhore dhe garohet me më shumë kandidatë. Subjekti politik e paraqet listën e kandidatëve në bazë të procedurave të caktuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, e në pajtim me ligjin për zgjedhjet e përgjithshme të Kosovës. Secila listë e kandidatëve duhet të ketë së paku 30% pjesëtarë të gjinisë femërore. Secili subjekt politik paraqitet në votim me listë të hapur. Votuesi voton për një subjekt politik të certifikuar dhe mund të votojë për një kandidat nga lista e kandidatëve të po atij subjekti politik. Ndarja e vendeve (ulëseve) në Kuvendin e Republikës së Kosovës bëhet sipas sistemit të përfaqësimit. Sipas sistemit në fuqi për zgjedhjet komunale, secila komunë e Kosovës konsiderohet zonë e vetme zgjedhore. Çdo kuvend komunal zgjidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë përmes votave të votuesve të regjistruar paraprakisht. Secili subjekt politik

i certifikuar duhet të paraqitet me listë të hapur votimi për çdo komunë në të cilën garon në zgjedhje. Vendet për çdo kuvend të komunës shpërndahen si në vijim: a) numri i përgjithshëm i votave të vlefshme, të fituara nga secili subjekt politik në komunë, përpjesëtohet me 1,3,5,7,9,11,13,15 etj, derisa numri i pjesëtuesve të shfrytëzuar t'i përgjigjet numrit të përgjithshëm të vendeve në atë kuvend të komunës; dhe b) koeficientët që rezultojnë nga vargu i pjesëtimeve rregullohen në renditje zbritëse. Ulëset u ndahen subjekteve politike (sipas koeficientëve) në atë mënyrë që vendi i parë i takon subjektit që e ka koeficientin më të madh, vendi i dytë subjektit që e ka koeficientin e radhës më të madh e kështu me radhë. Edhe për zgjedhjet për kryetar komune secila komunë, sipas legjislacionit në fuqi, konsiderohet një zonë e vetme zgjedhore. Për t'u kualifikuar si kandidat për kryetar komune, duhet që personi paraprakisht të ketë qenë banor i asaj komune së paku tri vjet. (Osman Ismaili, Mazllum Baraliju).

SITNICA. Lumë në pjesën qendrore të Republikës së Kosovës, lumi kryesor i Rrafshit të Kosovës dhe dega kryesore e lumit Ibër. Me sipërfaqen e përgjithshme ujëmbledhëse 2,874.9 km², lumi Sitnica formohet me bashkimin e lumit të Shtimjes dhe lumit të Sazlisë, në afërsi të fshatit Robovc. Gjatësia e lumit është 90 km, prej burimit deri në grykëderdhje (Mitrovicë), ku bashkohet me Ibrin. Shtrati i Sitnicës është i cekët, me pjerrësi të vogël, në të cilin janë zhvilluar meandrimet e shumta. Pellgu karakterizohet me reshje mesatare vjetore rreth 664 mm, ndërsa ujërat nëntokësore kanë ndikim të vogël. Koeficienti i rrjedhjes rreth 0.24, vlera e modulit të rrjedhjes luhartet prej 2 l/s/km² në pjesën qendrore të ujëmbledhësit, që është ndër vlerat më të vogla në territorin e Kosovës deri në 6 l/s/km², në afërsi të vijës ujëndarëse. Prurja mesatare vjetore është 12 m³/sek, prurja maksimale në muajin shkurt 24.5 m³/sek, ndërsa prurja minimale në muajin gusht 3.2 m³/sek. Prurja më e madhe në muajt e parë të vitit lidhet me lartësinë mbidetare të pellgut ujëmbledhës, që varet më shumë nga reshjet e shiut e të borës (regjim pluvionival). Sitnica shpeshherë del nga shtrati dhe vërshon tokat përreth. Vërshimet janë më të shpeshta gjatë reshjeve pranverore. Dy degët kryesore të Sitnicës janë Llapi (prurja mesatare

vjetore 4.1 m³/s) dhe Drenica (prurja mesatare vjetore 2 m³/s), ndërsa degë të tjera më të vogla janë: Graçanka, Gadimka, Prishtevka, lumi i Stantërgut etj. Në Mitrovicë derdhet në lumin Ibër. (Ruzhdi Pllana)

SITOV Aleksej (Petrovič) (1948-2012). Gjuhëtar rus, albanolog. Kreu studimet në degën e gjuhës dhe të letërsisë shqipe në Universitetin e Leningradit (1971). Punoi në Institutin e Gjuhësisë të Akademisë së Shkencave (dega e Leningradit, nga viti 1992 - Instituti i Studimeve Linguistike), ku pati edhe detyra administrative, si sekretari shkencor (1988-1991) dhe zëvendës drejtor për punë shkencore (1991-2012). Që në fillim interesimi i tij shkencor u përqendrua në fushën e gjuhësisë historike-krahasuese, posaçërisht rreth historisë së lashtë të shqipes. Nën udhëheqjen e Agnia Desnickajas mbrojti tezën për historinë e fleksionit foljor në gjuhën shqipe (1977). Në punime të mëtejshme vazhdoi studimin e rrugës së zhvillimit të strukturës foljore dhe trajtoi elementet indoeuropiane në këtë strukturë. Përgatiti kreun për huazimet latine në sistemin foljor të shqipes në përmbledhjen "Romano-Balkanica. Çështje të adaptimit të elementit gjuhësor latin në arealin ballkanik" (Voprosy adaptacii latinskogo jazykovogo elementa v balkanskom areale, Leningrad 1987). Si albanolog dhe ballkanolog u mor edhe me studimin sinkronik të gjuhës shqipe, duke shfaqur interesimin më të madh për kundërvëniet aspektore të kohëve të së shkuarës dhe për mënyrën habitore të shqipes, të cilën e vëzhgoi në krahasim me gjuhët përreth (sllavishtja jugore) dhe jashtë Ballkanit (gjuhët balltike, armenishtja, taxhikishtja). Së bashku me A. Zhugranë bëri përshkrimin e shqipes për vëllimin e parë të punimit kolektiv "Bazat e gjuhësisë ballkanike" (Osnovy balkanskogo jazykoznanija, Leningrad 1990). (Marija Morozova)

SKARDI. Mal në kufij të Ilirisë dhe të Maqedonisë. Sot njihet me emrin Mali Sharr. Njihet nga burimet antike si Scardus Mons dhe përmendet nga autorë antikë, si Polibi, Tit Livi, Straboni dhe Ptolemeu. Kullosat e mëdha që posedonte kanë bërë që aty qysh nga lashtësia të ushtrohet intensivisht veprimtaria blegtorale. Sipas malit mori emrin edhe Qeni i Sharrit, i përmendur dhe nga autorët antikë. (Arben Hajdari)

SKEJA Avni (1951-). Inxhinier i elektroteknikës, profesor universiteti. Lindi në Prizren, ku kreu shkollën fillore dhe të mesme. Kreu studimet për inxhinieri elektrike në Fakultetin Elektroteknik të Universitetit të Lubjanës (1975), studimet e magjistraturës në fushë të automatikës në Fakultetin Elektroteknik të Universitetit të Nishit, ndërsa studimet e doktoratës i kreu po në Lubjanë (1988). Për një kohë të shkurtër punoi si inxhinier i mirëmbajtjes në Industrinë e fijeve sintetike “Progres” në Prizren. Më 1976 u zgjodh asistent, më pas ligjërues, docent dhe më 1999 profesor inordinar në Fakultetin Elektroteknik të UP-së. Është autor i punimeve shkencore dhe profesionale nga fusha e automatikës. Kreu detyra dhe funksione të ndryshme në Fakultetin Elektroteknik. Pas dëbimit të studentëve dhe mësimdhënësve nga objektet e fakultetit (1991) u angazhua për funksionalizimin e studimeve pasuniversitare të magjistraturës e të doktoratës në këtë fakultet. (Nebi Caka).

SKËNDERAJ. Qytezë në Drenicë dhe qendër e komunës me të njëjtin emër. Shtrihet në pjesën qendrore të Kosovës, në lartësi mbidetare 615 m. Nëpër qytet kalon lumi Klina, degë e majtë



SKËNDERAJ

e Drinit të Bardhë. Ka pozitë të volitshme dhe paraqet një të rëndësishme komunikuese. Përmes rrugëve magjistrale lidhet me Drenasin, Mitrovicën, Istogun, Klinën dhe Vushtrrinë. Vendbanimi shënon zhvillim më të hovshëm gjatë shekullit XX. Ishte pronë e banorëve të fshatit Klinë e Poshtme. Pas Luftës së Parë Botërore filloi ardhja e kolonëve serbë dhe malazezë. Të ndihmuar nga pushteti, kolonët ndërtuan edhe objektet e para të infrastrukturës. Në vitin 1940 u shpall qytezë dhe seli komunale


për rrethin e Drenicës. Serbët e quanin Serbicë, ndërsa dikur quhej Saraj, që dëshmohet nga një lokalitet me këtë emër në jug të qytezës. Me emrin Skënderaj fillon të quhet që nga viti 1941. Skënderaj është qendër urbane, administrative, arsimore, shëndetësore, kulturore, tregtare dhe industriale për 48 vendbanime përreth. Lëvizja pozitive natyrore manifestohet me rritjen e vazhdueshme të numrit të popullsisë. Derisa në vitin 1948 Skënderaj kishte 454 banorë, në vitin 1981 kishte 3,071 banorë, ndërsa sipas të dhënave të regjistrimit të fundit (2011) vendbanimi kishte 6,612 banorë. Hapat e parë të zhvillimit në ekonomi, arsim, shëndetësi etj., i filloi pas Luftës së Dytë Botërore. Deri në vitet ‘70 të shekullit të kaluar ishte komunë tipike agrare, ndërsa i vetmi repart industrial ishte fabrika e tullave dhe e tjegullave, e ndërtuar në vitin 1948. Ndërtim i fabrikës së materialeve ndërtimore (1977), i fabrikës për prodhimin e miellit (1979), të municionit të gjuetisë (1976) dhe fabrikës për prodhimin e lodrave dhe produkteve të tjera të plastikës (1975) e shndërruan Skënderajn në qendër të rëndësishme industriale. Krahas industrisë, në këtë periudhë u zhvilluan edhe arsimi, kultura dhe shëndetësia. Ekonomia pësoi rënie gjatë viteve ‘90 të shekullit të kaluar, sidomos gjatë luftës së viteve 1998-99, kur përveç humbjeve në njerëz, u dogjën dhe u shkatërruan shumë objekte afariste e zejtare. Sot shumica e bizneseve janë ndërmarrje bujqësore, tregtare, shërbyese e ndërtimore, ndërsa të pakta janë ato industriale. Nga repartet industriale sot funksionon fabrika e materialit ndërtimor me 100 punëtorë dhe ajo për prodhimin e miellit. Përmes procesit të privatizimit objektet e tjera industriale e kanë ndryshuar destinimin, ndërsa disa janë mbyllur. (Ramiz Cërvadiku)

SKËNDERAJ (komuna). Komunë në veri-perëndim të pjesës qendrore të Kosovës, rreth 20 km në jugperëndim të qytetit të Mitrovicës dhe 50 km në perëndim të Prishtinës. Lartësia mesatare mbidetare sillet prej 500-700 metra, kurse pika më e lartë është mali i Çiçavicës me 1,091 m. Komuna e Skënderajt kufizohet në lindje me Vushtrrinë, në verilindje me Mitrovicën, në veri me Zubin Potokun, në perëndim me Istogun, në jugperëndim me Klinën dhe në juglindje me Drenasin. Sipërfaqja e komunës është 375 km² dhe përfshin 3,44% të territorit të Kosovës. Pozita qendrore ndërmjet

Rrafshit të Kosovës dhe Rrafshit të Dukagjinit paraqet një atribut të rëndësishëm të pozitës gjeokomunikative. Nëpër këtë komunë kalojnë rrugë të rëndësishme, si ajo Mitrovicë-Istog-Pejë, Skënderaj-Drenas, përmes së cilës lidhet me autostradën Prishtinë- Durrës dhe rrugët që e lidhin me qendrat dhe rajonet e tjera të Kosovës. Klima është kontinentale me dimra të ftohtë e të ashpër, sasia mesatare e reshjeve arrin rreth 600 mm. Rrjeti hidrografik është i varfër. Lumi kryesor është Klina, degë e majtë e Drinit të Bardhë. Qendër urbane dhe administrative e komunës është Skënderaj, e shpallur qytezë në vitin 1940, në të cilën gravitojnë 49 vendbanime. Shtimi natyror pozitiv dhe mobiliteti i vogël hapësinor janë rezultat i veçorive autarkike rurale dhe patriarkale të popullsisë. Kjo u manifestua në rritjen e vazhdueshme të numrit të popullsisë së komunës. Brenda periudhës 60-vjeçare popullsia e komunës është dyfishuar. Derisa në vitin 1948 kishte 24,149 banorë, sipas të dhënave të regjistrimit të fundit (2011) ajo kishte 50,858 banorë. Dendësia mesatare e popullsisë është 136 banorë/km².

Deri në vitet '70 të shekullit të kaluar komuna ishte tipike agrare, me pjesëmarrje të lartë të popullsisë bujqësore dhe dendësi të madhe agrare. Në këtë periudhë, me ndërtimin e disa fabrikave dhe kapaciteteve industriale, fillon të ndryshojë struktura ekonomike, e cila përshejton procesin e transformimit hapësinor dhe funksional të vendbanimeve të kësaj zone. Edhe sektorët e tjerë, si: komunikacioni, arsimi, kultura, shëndetësia, tregtia etj., filluan të zhvillohen po nga fundi i viteve '70 të shekullit të kaluar, kur hapen shumë shkolla të mesme e fillore, objekte shëndetësore, kulturore, tregtare etj. Zhvillimi ekonomik pësoi rënie në periudhën 1990-1999. Është njëra ndër komunat që gjatë luftës së fundit (1998-1999) pësoi dëmet më të mëdha në njerëz dhe në të mira materiale. (Ramiz Cërvadiku)

SKËNDERBEU Gjergj Kastrioti (1405-1468). Hero kombëtar, burrëshëtas, strateg ushtarak. Për veprën dhe jetën e tij ruhen mijëra dokumente zyrtare, vëllime historike e letrare-artistike të shkruara në më se 20 gjuhë. U realizuan gjithashtu edhe shumë vepra nga artet figurative, muzika, teatri, filmi etj. Pothuaj i tërë opusi historiko-letrar dhe artistik



PËRMENDORJA E SKËNDERBEUT NË PRISHTINË

kushtuar Skënderbeut mbështetet para së gjithash në veprat e humanistëve shqiptarë: M. Barleci, M. Beçikemi, M. Segoni, Dh. Frëngu, F. Bardhi etj. Në këtë frymë që nga fillimet e shek. XVI e deri në ditët e sotme kanë shkruar shumë historianë shqiptarë, italianë, gjermanë, anglezë, francezë, sllavë etj. Janë realizuar qindra vepra nga artet, si portreti i Heroit nga Gentile Bellini (1466), operë nga Antonio Vivaldi (1718), drama, poezi etj.

Vitet e para të fëmijërisë së Skënderbeut i takojnë kohës së lulëzimit të Principatës së Kastriotëve. Mirëpo, pas rënies së Krujës nën osmanët (1415), ai ishte i detyruar të shkonte peng në oborin e sulltanit. Çështja se kur u mor peng Skënderbeu, në historiografi përgjithësisht ka disa pasaktësi: 9-vjeçar ose 18-vjeçar; në vitin 1415 ose 1423. Atje Gjergji ishte konvertuar në mysliman dhe mori emrin Skënder (nga Aleksandër), si dhe u edukua në shkollën e icoçllanëve. Mori pjesë në fushata ushtarake kundër të krishterëve, për çarsye i ati kishte qenë i detyruar të kërkonte falje nga Senatit i Venedikut (1428). Për veprat e tij ushtarake u nderua me titullin bej dhe kështu me emrin Skënderbej (Scanderbeg) do të bëhet i njohur në gjithë botën.

Në vitin 1438, pasi kishte fituar besimin e Muratit II (1421-1451), Skënderbeu u emërua për komandant ushtarak i kështjellës së Krujës, si dhe vendosi kontakte me Venedikun (1438) dhe Raguzën (1439). Raguzë më 1439 e kishte

shpallur Skënderbeun për qytetar nderi, ndërsa një vit më parë këtë e kishte bërë edhe Venediku. Brenda këtyre viteve e ndeshim si sanxhakbej në Dibër (1440). Pas Betejës së Nishit (nëntor 1443), kur trupat osmane kishin pësuar me rastin e një ofensive hungareze të Janosh Huniadit, Skënderbeu dhe nipi i tij Hamzai, së bashku me 300 kalorës, braktisën forcat osmane dhe iu drejtuan Krujës, ku më 28 nëntor 1443 u ngrit përsëri flamuri i Kastriotëve.

Për të konsoliduar pushtetin e tij, Skënderbeu formoi aleanca përmes martesës me pjesëtarët e familjeve kryesore. Ai u martua me Donikën, bijën e Gjergj Arianitit, ndërsa motra tij, Mamica, u martua me Karl Muzak Topinë etj. Ishte meritë e Skënderbeut që mori përsipër për të themeluar Lidhjen e Princave Shqiptarë në Lezhë më 2 mars 1444. Lezha dikur ishte kryeqendra e Dukagjinëve, ndërsa në kohën e mbajtjes së Kuvendit, ajo ishte nën Venedikun. Kuvendi i Lezhës u mbajt mbi bazën e traditave më të hershme shqiptare. Sipas Barlecit, morën pjesë shumë princër, si: Pal dhe Nikollë Dukagjini, Lekë Zaharia, Pjetër Spani, Lekë e Pjetër Dushmani, Gjergj Stres Balsha, Andrea Topia, Gjergj Aranit Topia, Teodor Muzaka, Shtjefën Cërnojeviqi etj. Përfaqësuesi i Venedikut dhe ai i Raguzës, edhe pse ishin të ftuar, nuk qenë të pranishëm. Kuvendi i Lezhës mori një sërë vendimesh të rëndësishme, të cilat përcaktuan edhe natyrën juridike të këtij organi. Me gjithë diversitetet, për shkak të interesave të ndara, pjesëmarrësit në Kuvend u shprehën për bashkimin e tyre në luftë kundër pushtimit osman. Gjithashtu u vendos për formimin e një ushtrie të përbashkët (federale). Sipas traditës u themelua Besëlidhja, që u konsiderua si një lloj federate me një kryetar të vetëm, që ishte Skënderbeu i quajtur *Primus inter pares* (i pari ndër të barabartit).

Krahas politikës së brendshme, Skënderbeu i kushtoi rëndësi të madhe edhe politikës së jashtme. Në skenën europiane Skënderbeu kishte hyrë, kur ajo ishte e përçarë, sikurse edhe shqiptarët. Në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare, Skënderbeun do ta përfaqësonin një sërë diplomatësh, kryesisht nga radhët e klerit katolik, siç ishte argjipeshkvi Pal Engjëlli, abati Lazar, abati Gjergj Pelini i Novobërdës, pastaj vëllezërit Gazulli (Gjini e Pali), të cilët u morën me marrëdhëniet e

Skënderbeut me Raguzën, me Shtetin e Papës dhe me Mbretërinë e Hungarisë. Gjatë viteve 1443-1444, si dhe 1448-1456, Skënderbeu u lidh me Janosh Huniadin, për të luftuar në Fushë Kosovë dhe në Beograd.

Rezultatet do të bëhen të dukshme me rekrutimin e luftëtarëve: me një ushtri prej 15,000-20,000 vetash, gjatë viteve 1444-1446 Skënderbeu zmbrapsi 13 sulme osmane (Beteja e Torviollit, 1444). Gjatë viteve 1446-1448, 1450-1457, 1462-1465 arriti suksese në Dibër, Pollog, fushën e Domosdovës, Fushë-Kosovë, në grykat dhe luginat e Drinit dhe Shkumbinit, në Livadhi të Ohrit (1462), në Fushën e Vajkalit (1465) etj. Ka mbetur e pashlyeshme në dokumente relevante të kohës disfata e Muratit II, të cilin e shoqëruan rreth 100,000 ushtarë, për t'i rrethuar fortifikatat e Dibrës, Sfetigradit (1448) dhe të Krujës (1450), por pasi rrethimet nuk rezultuan me sukses, sulltani u detyrua të tërhiqej. Nga vargu i gjatë i fitoreve, duhet veçuar sidomos ajo në Ujëbardhë (1457), ku sulltani, për ta mundur Skënderbeun, i kishte dërguar 20,000 kalorës. Përveç dhjetëra dokumenteve zyrtare për këtë ngjarje, është i njohur edhe vlerësimi i kalorësit anglez, Xhon Njuport (John Newport), një pjesëmarrës vullnetar i betejës. Gjatë qëndrimit të tij në Romë (1458), ai kishte deklaruar: "Po të bjerë kështjella arbëroere, pushtimi i Europës nga osmanët është i sigurt, pasi nuk ka fuqi tjetër që ta bëjë këtë rezistencë".

Rezistenca e madhe në Krujë (1450), si dhe fitoret e mëparshme (1443-1450), mundësuan të rifillonte procesi historik për krijimin e shtetit të njësuar të Arbrit, që ishte ndërprerë nga pushtimet osmane. Pas Krujës më 1451, Skënderbeu zuri të quhet zyrtarisht "zot i Arbërisë" (*dominus Albaniae*). Ndërkohë, marrëdhëniet e Skënderbeut me Venedikun ishin përkeqësuar, për shkak të aspiratave venedikase ndaj krahinës së Dejës. Konflikti mes tyre u zgjidh me një traktat paqeje (1448), sipas të cilit Deja e Drishti kaluan nën Venedikun, por me një kompensim në dobi të Skënderbeut, në lartësi prej 1,400 dukatësh në vit.

Në luftërat e tij, Skënderbeu kishte mbështetjen e Shtetit të Papës, të Republikës së Venedikut dhe të Raguzës, të Mbretërisë së Napolit, si dhe të Mbretërisë së Hungarisë. Papa Calixtus III (1455-1458) e kishte nderuar me titullin "Atlet

i Krishtit', si dhe e kishte graduar për kapiten të përgjithshëm të Selisë së Shenjtë. Mbështetjen më të madhe e gjeti te mbreti aragonez, Alfonsi V i Napolit, i cili, sipas Traktatit të Gaetës (1451), Skënderbeun do ta kthente për vasal në ato toka që do të çliroheshin me forca të përbashkëta. Pavarësisht nga kjo, osmanët arritën të ngadhënjenin në Berat (1455), për ta detyruar më pastaj që Skënderbeu të zhvendosej në Napoli me 2,500 trupa, për të përmbushur detyrimin e tij sipas Traktatit. Ferdinand I (1458-1494), pasuesi i Alfonsit V (1458), kërkonte ndihmë për të mposhtur rivalin e tij, dukën Anzhu, që aspironte ta sundonte Napolin. Në Barletta dhe Trani ai arriti të mposhtë rivalin kryesor të Ferdinantit, Gian Antonio Orsinin, princin e Tarantos. Pas fushatës, një pjesë e ushtrisë së Skënderbeut mbeti në Itali, për ta themeluar koloninë e parë arbëreshe në Kalabri. Ndërkohë, u bënë përpjekje që luftërat e Skënderbeut të zgjeroheshin dhe të mbështeteshin edhe në planin evropian. Së pari, në konferencën në Mantova (1458), si dhe më pastaj (1464) nga Papa Pius II u shpall kryqëzata e shenjtë, e cila nuk u realizua, për shkak të vdekjes së tij (14 gusht 1464). Pas mbrojtjes heroike të Krujës gjatë rrethimeve II dhe III (1466/67), ku sulltani kishte angazhuar më se 150,000 ushtarë, Mehmeti II iu drejtua viseve të tjera të çliuara, për ta shkatërruar vendin. Vetëm në Çidhnë (1467) u vranë rreth 10,000 pleq, gra dhe fëmijë. Për ta përballuar gjendjen, Skënderbeu kërkoi ndihmën e shteteve mike. Në Romë i gjithë populli kishte vërshuar qytetin për ta parë luftëtarin e lavdishëm. Një vit më vonë Skënderbeu vdiq në Lezhë, më 17 janar 1468, i sëmurë nga ethet dhe u varros po aty. Atëherë në Lezhë u organizua edhe një kuvend i princërve dhe bujarëve të shquar shqiptarë, të cilët për herë të parë luftuan pa komandantin e tyre. (Jahja Drançolli)

SKËNDERI Bedri (1936-). Fotoreporter. Lindi në Prizren. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje. Një kohë punoi te fotografi i njohur Neshat Dizdari-Nesha, fillimisht në Prizren e pastaj në Prishtinë. Më 1960 nisi punë si fotoreporter në të përditshme "Rilindja". Është fotoreporteri i parë shqiptar në Kosovë. Fotografitë e tij të ngjarjeve të ditës, të personaliteteve të ndryshme, të objekteve ekonomike, kulturore dhe arsimore, të cilat u

botuan në "Rilindje" dhe në botimet e tjera në Prishtinë, përbëjnë një kronikë të veçantë të zhvillimeve në Kosovë. (Zenun Çelaj)

SKËNDERI Skënder (1934-). Fizikan, profesor universitar. Lindi në fshatin Zasellë (Kodër) të komunës së Mitrovicës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje dhe në Tunel të Parë (1951),



SKËNDER
SKËNDERI

gjimnazin në Mitrovicë, ndërsa studimet për fizikë i filloi në Beograd dhe i kreu në degën e fizikës në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës (1969). U zgjodh asistent në Fakultetin Teknik të Universitetit të Prishtinës dhe më pas ligjërues i lëndës së fizikës në seksionin e elektroteknikës dhe të ndërtimitarisë (1974). Studimet pasuniversitare i kreu në Fakultetin Teknologjik-Kimik të Universitetit të Zagrebit (1974), ndërsa tezën e disertacionit të doktoratës e mbrojti në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore (FSHMN) të Universitetit të Prishtinës (UP) në vitin 1989. Ka qenë nënkryetar Kuvendi të Kosovës, i cili shpalli Deklaratën Kushtetuese të 2 Korrikut të vitit 1990. Pasuroi literaturën kompjuterike me botimin e teksteve të para nga kjo fushë në Kosovë. Është autor i teksteve për shkolla të mesme dhe i teksteve universitare ("Përmbledhje detyrash nga fizika, për studentët e fakulteteve teknike", "Fizika, për studentët e fakulteteve teknike", "Sistemi ndërkombëtar i njëjësive fizike SI" etj.). Është bartës i shumë mirënjohjeve dhe dekoratave. (Rexhep Gashi)

SKIROI Zef (Giuseppe Schirò) (1865-1927). Poet, publicist, folklorist, historian, profesor universiteti. Lindi në Horën e Arbëreshëve, Palermo. Mësimet e para i mori në Seminarin Arbëresh të Palermos, të themeluar nga atë Gjergj Guxeta, pastaj vazhdoi studimet në liceun klasik të Palermos Vittorio Emanuele II, ku lidhi miqësi me Luigi Pirandellon. Studioi për Drejtësi në Universitetin e Palermos (1881), ku u diplomua në vitin 1890. Cristina Gentile Mandalà e njohu me mjediset intelektuale arbëreshe dhe falë saj hyri në kontakt me figura si Zef Serembe dhe Jeronim De Rada. Mbajti letërkëmbim të ngushtë me albanologë evropianë (Meyer, Dozon), me intelektualë



ZEF SKIROI

gjuhës dhe letërsisë shqipe pranë atij universiteti, ku më vonë kreu edhe funksionin e drejtorit të departamentit. Në vitin 1913 mori pjesë në punimet e Kongresit të Triestes dhe më pas e vizitoi dy herë Shqipërinë. Bashkëpunëtor i ngushtë në shumë të përkohshme shqiptare të kohës, themeloi dhe drejtoi disa revista: “L’Arbri i rii” (1887), “Archivio albanese” (1890) dhe “Flamuri i Shqipërisë” (1904).

Skiro qysh i ri nisi të shkruajë poezi. Ishte adoleshent kur botoi poemthin “Scanderbeg”, të titulluar më vonë “Kroja”. Mes veprave të tij poetike kujtojmë vëllimin në italisht “Vargje” (Versi, 1887); përmbledhjen “Rapsodi shqiptare” (Rapsodie Albanesi, 1887), që pati sukses të menjëhershëm ndër bashkëkohësit; idilin “Milo e Haidhe” (1890, 1900, 1907); lirikat patriotike “Kënkat e luftës” (1897), poemën epike “Te dheu i huaj” (1900), varianti i ripunuar u botua pas vdekjes së autorit në vitin 1940); poemën “Këthimi”, botuar pas vdekjes në vitin 1965; “Mino” (1923); lirika të shumta të botuara në të përkohshmet shqiptare dhe arbëreshe, si edhe dy vëllimet “Kënka të përshtyrëshme të Shqyptarëve të Sicilisë” (1907) dhe “Kënka tradicionale dhe sprova të tjera të ngulimeve arbëreshe të Sicilisë” (1923). Kërkimet e tij historike u përmblodhën në disa shkrime, ndër të cilat më i rëndësishmi mbetet “Shqipëria dhe çështja e Ballkanit” (L’Albania e la questione Balcanica, 1904), pastaj një sërë punimesh folkloristike, letrare, historike, gjuhësore dhe juridike, një numër syresh ende të pabotuara. Z. Skiro është një nga përfaqësuesit më të mëdhenj të letërsisë romantike dhe të Rilindjes Kombëtare Shqiptare dhe konsiderohet nga shumë studiues si vijuesi i veprimtarisë politiko-letrare të De Radës. Në veprat e tij ndihet përpjekja për të realizuar një program letrar ambicioz që përmes rindërtimit të epopesë së arbëreshëve synonte të promovonte palingjenezën e atdheut të të parëve, çka mbeti objektivi kryesor ideologjik i

shqiptarë (Mitko, Pashko Vasa, Kristoforidhi, Naim Frashëri, Gurakuqi) dhe sicilianë (Pirandello, Pitre, Marino). Në nëntor të vitit 1900, me hapjen e mësimdhënies së shqipes në Institutin Oriental të Napolit, Skiro u emërua profesor u

gjithë krijimtarisë së tij të gjerë letrare. Vdiq në Napoli. (Matteo Mandala’)

SKIVJANI. Fshat në komunën e Gjakovës, rreth 5 km në veri të qytetit. Shtrihet në të dy anët e rrugës Gjakovë-Pejë, në lartësi mbidetare 425 m. Është vendbanim fushor i tipit të grumbulluar, me sipërfaqe kadastrale prej 860 ha. Në mes të fshatit janë gjetur gjurmë të periudhës romake, që dëshmojnë se ishte vendbanim i vjetër dhe shumë më i madh se Gjakova. Në dokumentet e hershme të vitit 1020 (Krisobula e Deçanit) përmendet me emrin Livjan. Në defterin kadastral turk të vitit 1485 ishte i regjistruar me emrin Slivlan, ndërsa me emrin Skifiani është regjistruar në një hartë austriake të vitit 1689. Disa nga familjet që jetojnë në Skivjan janë të ardhur nga sanxhaku i Nishit pas vitit 1878. Nga viti 1928 e deri në fund të shekullit të kaluar këtu u vendosën edhe kolonë nga Serbia, Mali i Zi dhe Bosnja e Hercegovina. Sipas shënimeve të vitit 1838, fshati kishte 300 banorë, të gjithë shqiptarë. Në vitin 2011 kishte 2,254 banorë, ndaj 764 banorëve në vitin 1921. Popullsia merret kryesisht me bujqësi, perimtari dhe blegtori. Është qendër lokale e disa vendbanimeve përreth: Hereç, Plançor, Dujakë, Osek, Hylë. Ka shkollë 9-vjeçare, qendër shëndetësore, disa objekte tregtare etj. (Qerim Kastrati)

SKLLAVINITË. Rajone ose zona të lidhura mes veti, të banuara me fiset sllave, të themeluara në fund të shek. VI dhe në fillim të shek. VII. Këto rajone, që shtriheshin në disa pjesë të Maqedonisë Jugore të sotme dhe të Maqedonisë së Egjeut, u zhvilluan me shpejtësi nën ndikimin e popullsisë vendase dhe të autoriteteve bizantine. Rajonet ose zonat e tilla, sipas kronikave bizantine të shek. VII-IX (602-836/37), u quajtën Skllavini, përkatësisht aleanca të fiseve sllave. Perandorët bizantinë, të zënë me luftëra kundër persëve dhe arabëve në Lindje, morën formalisht zotërimin mbi këto zona dhe fise, duke iu ndarë të parëve të tyre shpërblime dhe tituj. Megjithatë, sulmet e shpeshtuara sllave në Selanik, të shoqëruara edhe më piratëri, nxitën Bizantin që të ndërmerre masa ushtarake ndaj “Skllavinive” (658, 688). Burimet e shek. X-XI dëshmojnë se “Skllavitë” (*Skllavinae terra*) u shtrin edhe gjatë Adriatikut Lindor, si dhe në hinterland, sipas kësaj radhe: Doklea, Trabunia, Paganja,

Kroacia dhe Serbia. Emri "Sklavonia" (Sllavonia e sotme në Kroaci) përmendet për herë të parë në shek. XI. Ndërsa emri "Sllaveni", që i referohet Sllavenisë së sotme, dëshmohet nga mesi i shek. XIX. (Jahja Drançolli)

SKOK Petar (1881-1956). Gjuhëtar kroat, onomast, albanolog. Studimet për romanistikë, filologji gjermanike dhe gjuhësi indoeuropiane i mbaroi në Universitetin e Vjenës (1900-1904). U



PETAR SKOK

doktorua me tezë mbi "Toponomastikën e Francës Jugore". Mbahti mësim në Banja Lukë dhe shërbeu si bibliotekar i Muzeut Mbretëror në Sarajevë. Nga 1919 deri në pension punoi në Seminarin e romanistikës të departamentit të Fakultetit të Filozofisë në Universitetin e Zagrebit. Iu përkushtua studimeve gjuhësore të Europës Juglindore, kryesisht gjuhëve romane; latinishtes vulgare, dalmatishtes e me interes të veçantë ndikimit të romanitetit mbi dialektet kroate dhe mbi gjuhë të tjera të Europës Juglindore. Studioi historinë e sllavëve, gjuhët dhe bashkëveprimet e gjuhëve nga brigjet lindore të Adriatikut deri në brendësi, me theks të veçantë në onomastikë. Disa nga librat e tij të njohur janë:

"Terminologjia jonë detare dhe e peshkimit në Adriatik" (1933), "Arritja e sllavëve në Mesdhe" (1934), "Sllavët dhe katolicizmi në ishujt e Adriatikut I-II" (1950), "Fjalor etimologjik i gjuhës kroate ose serbe" (1971-1974) etj. Botoi studime historike për çështje gramatikore të shqipes dhe një numër etimologjish të fjalëve shqipe, të gjuhëve të lashta ballkanike, ndër të sidomos të ilirishtes etj. (Mensur Vokrri)

SKULPTURA. Një nga llojet e artit, formë e shprehjes artistike, e pranishme edhe në kulturën tonë të traditës dhe në kulturën bashkëkohore. Në traditën tonë është zhvilluar me shekuj, përmes objekteve për shfrytëzim në jetën e përditshme, të rregullimit të enterierëve, të hapësirave të banimit ose të eksterierëve të ambienteve shoqërore dhe publike, përfshirë këtu edhe praninë e figurave të mirëfillta skulpturale. Por rrethanat historike në Kosovë kanë qenë për një kohë të gjatë të pafavorshme për kultivimin e arteve figurative,

pra edhe të skulpturës. Kjo rrethanë e ka vonuar përfshirjen e Kosovës në rrjedhat e kulturës dhe artit europian, veçmas gjatë periudhës së gjatë të pushtimit. Megjithatë, kjo nuk e ka ndaluar zhvillimin e artizanaleve dhe të mjeshtrive artizanale, siç ishte zbulimi i veglave të punës, i mjeteve të përdorimit të përditshëm në bujqësi, blegtori dhe amvisëri, pastaj në stolisjen e armëve, të gdhendjeve në djepa, në lesa, furka, të kutive të nuseve, të gurëve në portat e kullave, në grykat e pusëve etj. Të gjitha këto gdhendje dëshmojnë për kreativitetin e krijuesve anonimë dhe zotërimin e mjeshtrisë së modelimit në gur dhe në dru, si dy nga materialet bazë të punës skulpturale. Megjithatë, periudha e filleve të artit të kultivuar dhe të artit të mirëfilltë bashkëkohor në Kosovë nisi me themelimin e Shkollës së Artit në Pejë, më 1949. Aty dalin kuadrot e para të artistëve, me formim sipas programeve bashkëkohore të mësimin, që në atë periudhë aplikohesh në të gjitha shkollat e ngjashme në ish-Jugosllavi. Ndërkaq, në vitin 1962 u hap Shkolla e Lartë Pedagogjike në Prishtinë, në kuadër të së cilës vepron edhe grupi i artit figurativ, që kishte për qëllim ngritjen e kuadrit të kualifikuar për mësues arti në nivelin fillor dhe të mesëm të arsimit në Kosovë dhe në hapësirat shqiptare të ish-Jugosllavisë. Më vonë, nga grupet e profilet e kësaj shkolle u formua Akademia e Arteve (1974), prej nga dolën krijuesit e mirëfilltë, të cilët pasuruan aktivitetet e arteve figurative në Kosovë. Skulptura si fushë e këtyre arteve figurative sot zhvillohet me intensitet të shpejtë, ashtu si edhe piktura, arkitektura etj. Qendra e zhvillimit të skulpturës që nga themelimi i Akademisë së Arteve bartet pikërisht në këtë institucion të shkollimit të lartë. Nga ky institucion çdo vit dalin skulptorë të rinj, që inkuadrohen në rrjedhat e reja të artit pamor. Për themelimin e degës së skulpturës në këtë institucion, si dhe për vendosjen e bazave të zhvillimit të këtij arti në Kosovë meritë të veçantë ka grupi i parë i mësimdhënësve dhe i skulptorëve në Kosovë: Svetomir Arsiq-Basara, Radoslav Musa Miketiq dhe Agim Çavdarbasha. Nga ky grup kontributin më të madh e ka dhënë Agim Çavdarbasha qoftë me veprimtarinë e tij, qoftë me punën pedagogjike dhe profesionale në ngritjen dhe përkrahjen e skulptorëve të rinj. Gjeneratat e reja të artistëve që arrijnë të shkollohen edhe në qendrat e mëdha gjithandej nëpër botë, sot marrin edhe

përvojën e shkollave të tjera dhe pasurojnë skulpturën e re në Kosovë me individualitete të ndryshme krijuesish. (Agim Rudi)

SLLAMNIKU Besim (1942-). Mjek, otorinologolog, profesor universiteti. Lindi në Gjilan, arsimimin bazë e mori në vendlindje, studimet i kreu në Fakultetin e Mjekësisë të



BESIM SLLAMNIKU

Universitetit të Shkupit (1964). Pas diplomimit u punësua në Spitalin e Përgjithshëm të Prishtinës. Kreu specializimin për otorinologologji (ORL) në Zagreb dhe në Stokholm (1971). Mbrojtiti tezën e doktoratës më 1977 në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. Më 1972 u zgjodh asistent, më pas docent, profesor inordinar dhe në vitin 1988 mori titullin profesor ordinar. Ishte shef i katedrës së ORL-së të Fakultetit të Mjekësisë dhe nga viti 2000 e deri në 2007 mbajti pozitën e drejtorit të Klinikës së ORL-së. Ishte kryetar i Shoqatës së Otorinologologëve të Kosovës, kryetar i Shoqatës së Onkologëve të Kosovës etj. Ka marrë pjesë në kongrese e simpoziume dhe ka publikuar shumë punime shkencore-profesionale në vend dhe jashtë si autor dhe bashkautor. Është bashkautor i tri teksteve universitare, ndër të cilët edhe i tekstit jugosllav "Otorinologologjia për studentë të mjekësisë dhe të stomatologjisë", i botuar në Zagreb në vitin 1981 dhe 1991. (Isuf Dedushaj)

SLLAVËT. Grup i madh i popujve indoeuropianë, të ngjashëm për nga gjuha dhe kultura. Etnogjeneza e emrit sllav dhe historia e hershme e sllavëve ende janë të panjohura. Historianët mendojnë se njoftimet e para për to i japin autorët romakë të shek. I-II, të cilët i përmendin me emrin "venedë". Gjatë shek. V-VII autorët bizantinë i përmendin me emrat "skllavinë" dhe "antë" dhe, së këtejmi, banorët autoktonë *skja*, *skije* ose *shkja* (në latinishten vulgare *sclavus*). Kjo larmi informacionesh ka bërë që në shkencën historiografike të paraqiten pikëpamje të ndryshme rreth përkufizimit të atdheut të parë të sllavëve. Sipas një hipoteze, atdheu i tyre shtrihet midis detit Baltik në veri dhe Detit të Zi në jug, Karpateve në perëndim dhe Donit, Volgës së Epërme dhe Novgorodit në lindje. Sipas hipotezës tjetër, që

ka më shumë mbështetës, atdheu i tyre i parë ishte shumë më i vogël. Ai shtrihet në lindje të Karpateve, në hapësirën midis kënetave të Pripjatit, Dnjeprit dhe rrjedhave të sipërme të lumenjve që derdhen në Detin e Zi (Prut, Dnjestër, Bug), pra në Bjellorusinë e sotme dhe në Ukrainë.

Sllavët e lashtë jetonin në bashkësi gjinore-fisnore. Ata, nën trysninë e shpërnguljes së popujve të tjerë, u dyndën në tri drejtime: drejt lindjes, perëndimit dhe jugut. Me këtë rast u formuan tri grupe etnike sllave: të lindjes (rusët, bjellorusët dhe ukrainasit), të perëndimit (çekët, sllovakët, polakët, sllavët polabë, serbët e Lluzhicës etj.) dhe të Jugut (kroatët, serbët, sllovenët etj.).

Sllavët në mënyrë të pavarur ose në aleancë me bullgarët (me origjinë turanike) dhe avarët (me origjinë mongole), në shek. VI ndërmorën një sërë sulmesh ndaj Gadishullit Ballkanik. Ata arritën deri në afërsi të Durrësit (548), të Konstandinopojës (551, 584), të Selanikut (584, 586), deri në Peloponez të Greqisë (584), shkretuan Epirin (587-588), pushtuan përkohësisht Lezhën (592), rrënuan qytetin e Dioklesë në provincën e Prevalit etj. Në fillim të shek. VII, sllavët pjesërisht shkretuan Dardaninë, Maqedoninë dhe vise të tëra në Greqi.

Dyndja sllave në fund të shek. VI dhe në fillim të shek. VII u shoqërua me dukurinë e ngulimeve në Ballkan. Ata formuan të ashtuquajtura "skllavinë" (vende të sllavëve), si në Maqedoni, Traki, Thesali, Beoti dhe në Peloponez. Iliria Veriore u kolonizua nga fiset sllave, të cilët me kohë asimiluan kryesisht popullatën autoktone ilire. Bërthama e vendeve rasiane-serbe u bë Rasha, që e mori emrin nga kështjella me të njëjtin emër, në veri të Novi-Pazarit të sotëm. Masa sllavësh u vendosën në zonën e Nishit, përgjatë luginës së Vardarit deri në Selanik dhe në malësitë midis Thesalisë dhe Epirit (malet e Pindit). Grupe të izoluara sllave u vendosën përgjatë luginave të Devollit dhe të Vjosës në Shqipërinë Jugore, por aty nga fundi i shek. VII, Perandoria Bizantine filloi të shpërngulë popullsi të tëra sllave nga viset e saj, duke i çuar në Azinë e Vogël. Në tërësi, vendet ku sot jetojnë shqiptarët, në shek. VI-VII u prekën jo me përmasa të mëdha nga ngulimet sllave.

Në shekujt në vazhdim, sllavët pranuan marrëdhëniet feudale dhe krishterimin, duke krijuar formacionet e tyre shtetërore. Ata

kaluan nëpër etapa të caktuara të zhvillimit, duke pësuar rënien dhe ngritje. (Qerim Dalipi)

SLLAVISHTJA. Gjuhë e sllavëve, degë e gjuhëve indoeuropiane, e afërt me baltishten. Janë tri grupe të gjuhëve sllave: lindore (rusisht, ukrainisht e bjellorusisht); perëndimore (polonisht, çekisht, sllovakisht, kashubisht, sorabishte luzitane dhe polabisht, kjo e fundit tashmë gjuhë e vdekur) dhe jugore (sllavishte e vjetër, bullgarisht, maqedonisht, serbisht, kroatisht, bosnisht, malazezisht, slovenisht). Gjuhët sllave kanë karakter arkaik, sidomos në sistemin e deklinacionit. Shkrimi i parë i sllavishtes është i shekullit IX, glagolitiku me 22 shenja, ndërsa ciriliku pas shekullit X, derivuar nga majuskulat greke. Sllavishtja e vjetër, e shkruar qysh në shekullin X ishte gjuhë e vetme letrare me shërbim të gjerë në kishë, po edhe në jetën kulturore përgjithësisht. Në kohën e shkrimeve të para, gjuhët sllave nuk ishin të diferencuara midis tyre. Mendohet se shekujt XI dhe XII janë koha e kalimit nga gjuha e fiseve në gjuhët e popujve të sllavët e jugut e të perëndimit, ndërsa të sllavët e lindjes ky diferencim është më i vonë, i shekullit XIV. Procesi i krijimit të gjuhëve letrare më pas vazhdon deri në kohën e rilindjes kombëtare të secilit popull. Gjuha letrare e vjetër, që lidhet me shërbimin kishtar, njihet si sllavishte e vjetër kishtarë, si sllavishte e vjetër, por edhe si bullgarishte e vjetër. (Lindita Rugova)

SLLAVIZMAT. Element gjuhësor, fjalë, shprehje, frazeologji që është huazuar nga ndonjë gjuhë sllave në ndonjë gjuhë joslave, konkretisht në gjuhën shqipe, e cila ka kontakte me gjuhët sllave të jugut që zgjasin me shekuj. Dyndjet e para sllave në Ballkan janë nga sh. VI si fise ende të padiferencuara. Deri në sh. VIII flitet për sllavishte të përbashkët, ndërsa pastaj për bullgarishte-maqedonishte dhe serbishte-kroatishte (sot serbishte, kroatishte, boshnjakishte dhe malazezishte standarde). Ky kontinuum sllavojugor shfaqet në varietete dialektore me histori të ndryshme. Të folmet bullgare dhe maqedonase paraqesin një tjetër kontinuum të zbërthyer në dialektet më tej nga ana e saj. Janë shënuar mbetje të folmesh sllave në Shqipëri (rreth Korçës e në Gorë e Gollobërdë). Shqipja ka pasur kontakte intensive me varietetet e folura sllavojugore serbe-malaziase, në një anë, dhe bullgare-

maqedonase në anën tjetër. Kontaktet janë zhvilluar në rrethana të ndryshme: të pushtimit bullgar në hapësirat e një pjese të Kosovës në shek. IX-X dhe të pjesëve të Shqipërisë Juglindore e Jugore në shek. X-XI; të pushtimit serb në Kosovë e në vise të tjera në sh. XII-XIV, të bashkëjetesës nën sundime të ndryshme në hapësira të Malit të Zi, të Sanxhakut, të Kosovës, ashtu si në hapësira të tjera, sidomos në Maqedoni, në periudhën osmane. Pas 1912 mbi gjysma e popullsisë shqiptare mbeti nën sundimin jugosllav dhe në këtë periudhë kemi një valë të re huazimesh sllave në shqipen (serbe, për një pjesë malaziase dhe maqedonase). Gjatë periudhës komuniste në Shqipëri ka pasur faza të ndikimit kulturor rus, prej nga kanë mbetur huazime sllave (*zbor*, etj.). Kontaktet e tipit të një bilinguizmi në përdorimet publike midis serbishtes e shqipes në Kosovë kanë marrë fund në vitet '90 e më vonë dhe tani kanë ardhur breza që nuk e zotërojnë më atë gjuhë, ndërsa ato vazhdojnë në luginën e Preshevës, në Sanxhak e në Malin e Zi me serbishten dhe në Maqedoni me maqedonishten. E folmja e Arbneshtit të Zarës është ndodhur në mjedis kroatishtfolës qysh nga shek. XVIII dhe dëshmon për ndikime të fuqishme kroate, ashtu si të folmet e Ukrainës e të Mandricës në Bullgari.

Huazimet sllave të shqipes nuk e kanë pësuar rotacizmin, prandaj nuk mund të jenë më të hershme se shek. VIII (sanë, zakon). Sllavizma të hershëm merren: *matukë, Pushtricë, karrutë* (nga *motyka, Bystrica, Koryto*) në Shqipëri të mesme e jugore, ashtu si *grusht, shtëpâ (grst, stopan)* me *sh* për *s*, para sh. X. Më të shumtë janë sllavizmat pas sh. X dhe me diferencime të pjesërishme serbo/bullgare: *megje, opangë* në veri, *mezhdë, opingë* në jug. Pas sh. XII e më vonë kemi huazime më të shumta sllave: *kosë, kosh, lopatë, nevojë, prag, strehë, zakon, porotë, rod, çorodit, mitë, carinë, koritë, mrezhë, grusht, trup, zhabë, sokol, grazhd, oborr, rend, brazdë, pleh, patkua, gjobë, rob, vojvodë, çudi, grabit, neverit, vozit, dihas, vikas, sundoj*. Në shqipen kanë hyrë dhe disa prapashtesa sllave: *-ac: dorac, tullac; -avec: ligavec, grindavec; -icë: buallicë, gomaricë; -inë: luginë; -ishtë: jarishtë, baltishtë; -nik: petanik; -it: rendit, neverit*, etj. Sllavizmat e shqipes janë studiuar nga F. Mikloshić, A. M. Selishçev, N. Jokl, P. Skok, S. Riza, H. Bariq, V. Çimohovski, I. Popoviq, A. Desnickaja, I. Ajeti,

E. Hemp, E. Çabej, J. Gjinari, I. Duridanov, M. Blaku, Q. Murati, G. Svane, V. Stanishiq, A. Omari, Xh. Ylli, R. Ismajli, H. Shabani, M. Kërstiq etj. (Rexhep Ismajli)

SMAJLAJ Maxhun (1964-). Gazetar. Lindi në fshatin Poterç të Klinës. Shkollën fillore e kreu në Drenoc, të mesmen në Klinë, ndërsa studimet për histori i ndoqi në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës. Nga marsi i vitit 1997 filloi punën në gazetën e përditshme “Koha ditore”, si korrespondent nga Klina, pastaj në programin për Kosovë të Radiotelevizionit Shqiptar. Gjatë kohës së luftës (1998/99) raportoi nga rajonet e Klinës, Pejës, Istogut, Deçanit, Skënderajt etj. për mediet vendore dhe të huaja. Botoi dy libra publicistikë me tematikë nga lufta dhe është autor i 1,600 fotografive nga lufta e fundit në Kosovë. Jeton në Gjermani. (Bajrush Morina)

SMAJLI Armend (1986-). Aktor. Lindi në Pejë. Shkollën fillore dhe atë të mesme i kreu në vendlindje, studimet për aktrim në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës (2007). Në Teatrin Kombëtar luajti në shfaqjet: “Rebelët”, “Macja mbi çatinë e nxehtë”, “Beselam pse me flijojnë”, “Rock n Roll”, “Nata e Dymbëdhjetë”, “Vdekja e një komisioneri” dhe “Shopping and fucking”, ndërkaq në Teatrin e Pejës në shfaqjet: “Rrëfimet e narkomanëve”, “Varri i qyqes” dhe “Darka private”. Në Teatrin “Dodona” luajti në shfaqjet: “Kush vjedh një këmbë ka fat në dashuri” dhe “Këngëtarja tullace”. Luajti edhe në Teatrin “Oda” në shfaqjet: “Ëndrra e një nate vere”, “Sikur kjo të ishte shfaqje”, “Speed the Plow” dhe “Burrneshat”, pastaj në Qendrën Multimedia në shfaqjet: “Shembja e kullës së Ajfelit” dhe “Romeo e Zhuljeta” dhe në shfaqjen “Zemra e huaj apo traktati teatror për kufirin” të produksionit “Art Hub” nga Sarajeva etj. Përveç në teatër, ka luajtur edhe në filmat e metrazhit të gjatë “Babai” dhe “Ama dorën”. Ka luajtur edhe në disa seriale televizive vendore. (Naime Beqiraj)

SMAJLI-QERRATAJA Alush (1899-1946). Lindi në Llazicë të Llapushës. Shkrim-leximin e mësoi si autodidakt. Mbante lidhje me shqiptarët e mërguar në Stamboll, Bukuresht, Sofje, Kajro etj. Nga represioni i pushtetit serb në fillim të viteve ’30 u shpërngul në Shqipëri. U vendos në Kukës dhe më pas në

Rrashbull të Durrësit. Pas fillimit të Luftës së Dytë Botërore dhe zgjerimit të pushtetit të Shqipërisë në Kosovë, me familje u kthye në vendlindje. Kundërshtoi bashkëpunimin me komunistët dhe mori pjesë në shumë aksione për mbrojtjen e kufijve të Kosovës veriore nga sulmet e njësiteve çetnike. Në gjysmën e parë të vitit 1944 u zgjodh kryetar komune në Kijevë. Më 21 nëntor 1944 në Pllaçicë udhëhoqi luftën kundër forcave partizane të Batalionit të Rakoshit. Më pas me çetën e tij bashkërendoi veprimet me prijësit e çetave të tjera nacionaliste shqiptare. Mori pjesë aktive në shumë beteja dhe kuvende të forcave nacionaliste shqiptare, që luftonin kundër rikthimit të pushtetit jugosllav në Kosovë. U vra në përballje me njësitet e Brigadës V Partizane Kosovare, te Lugu i Lejthisë, në Gollboc më 1 prill 1946. (Haki Kasumi)

SMAKAJ Smajl (1951-). Gazetar. Lindi në Bllagajë (Arrishte) të Pejës. Shkollën fillore e kreu në fshatin Qyshk, gjimnazin në Pejë, kurse Fakultetin e Shkencave Politike në Zagreb, ku përfundoi edhe studimet pasuniversitare. Punoi gazetar i “Rilindjes”, pastaj kryeredaktor i Televizionit të Prishtinës, korrespondent nga Kosova dhe Maqedonia për mediet në Kroaci dhe Bosnjë e Hercegovinë. Pas luftës ishte zëvendësudrejtor i Radiotelevizionit të Kosovës (RTK), më pas redaktor i emisioneve dhe i programeve informative në RTK. Nga gjuha kroate e serbe përktheu në gjuhën shqipe disa libra (ndër të cilat edhe poemën “Skënderbeu” të Andrija Kacic Mioshiq), ndërsa në kroatisht përktheu romanin “Darka e gabuar” të Ismail Kadaresë. Është autor i disa librave: “Emblemë nate” (1998), “11 intervista” (2005), “Shëtitje me Azemin” (2010), “Bashkëbisedime” etj. (Shaqir Foniqi)

SMIRNOVA Nina Dmitrievna (1928-2001). Historiane ruse, albanologe. Pas diplomimit në shkencat historike, në vitin 1950, emërohet në Institutin e Historisë të Akademisë së Shkencave të Rusisë. Në vitet 1955-1956 punoi përkthyesë në Tiranë, në kuadrin e Komitetit Shtetëror për lidhjet me vendet e tjera. Në vitet 1968-1974 punoi në Institutin e Sllavistikës në Moskë, më pas në Institutin e Historisë së Përgjithshme të Akademisë së Shkencave të Rusisë. Ka botuar gjashtë monografi, kryesisht, mbi politikën e Shqipërisë dhe të

Italisë, midis tyre: “Formimi i Republikës Popullore të Shqipërisë 1939-1946” (1960); “Politika ballkanike e Italisë fashiste”, “Skicë e historisë diplomatike, 1936-1941” (1969); “Politika e Italisë në Ballkan. Skicë e historisë diplomatike 1922-1935” (1979). Në vitin 2003, pas vdekjes, u botua libri i saj më i njohur, “Shqipëria përgjatë shekullit XX”. U mor edhe me publicistikë shkencore, me studimin dhe publikimin e dokumenteve arkivore. Në librat dhe shkrimet e saj, N. Smirnova ka mbrojtur tezaz se shqiptarët janë një nga popujt më të lashtë të Gadishullit Ballkanik, se kanë prejardhje ilire, se Kosova nuk është Çeçeni etj. Në disa raste është përfshirë në debate e polemika publike me politikanë rusë, duke kundërshtuar qëndrimet e tyre antishqiptare dhe proserbe. Vdiq në Moskë. (Islam Lauka)

SMREKONICA. Fshat i tipit të dendur, 3 km në veriperëndim të Vushtrrisë. Shtrihet në afërsi të rrugës Vushtrri-Mitrovicë, në lartësi mbidetare 645 m. Sipërfaqja e territorit të fshatit është 424 ha, nga e cila 70% janë ara, të tjerat livadhe dhe pyje. Popullsia merret me bujqësi. Kultivohet gruri, misri, perimet etj. Në maje të kodrës afër fshatit gjenden gërmadhat e një kështjelle të vjetër me emrin Gjytet. Kjo dëshmon për lashtësinë e këtij vendbanimi. Në defterin kadastral osman të vilajetit Vëllk (1455) figuron me emrin Smrekonica me 7 shtëpi. Në vitin 2011 Smrekonica kishte 1,646 banorë, ndaj 260 banorë në vitin 1921. Nga objektet e standardit shoqëror ka shkollën fillore, stacionin shëndetësor, disa njësi tregtare dhe shërbyese etj. (Bajram Kafexholli)

SNOJ Marko (1959-). Gjuhëtar sloven. Lindi në Lubjanë, ku i mbaroi studimet për gjuhësi krahasimtare indoeuropiane dhe për hetitshen. Po në Lubjanë kreu studimet pasuniversitare dhe u doktorua me temë të historisë së sllavishtes (1989). Studioi edhe në Gjermani (1991-1992). Është profesor i gjuhësisë krahasimtare indoeuropiane në Universitetin e Lubjanës. Është anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Sllovenisë. Me shqipen nisi të merret herët, ndërsa ishte edhe pjesëmarrës disa herë në Seminarin Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare. Botoi artikuj studi-morë, libra, në mesin e të cilëve edhe fjalorin etimologjik të slovenishtes. Për shqipen ka

disa botime. Shkroi një gramatikë të shqipes (1991) dhe botoi Fjalorin e anasjellë të shqipes (“Rückläufiges Wörterbuch der albanischen Sprache”, 1994). Botoi artikuj për studimet albanistike në Slloveni dhe ishte bashkëredaktor (me R. Ismajlin) i veprës albanologjike së Nahtigalit, të botuar në Prishtinë dhe Lubjanë (2015) dhe të Mikloshiçit (2007). (Lindita Rugova)

SOÇANICA. Fshat kodrinor-malor në komunën e Leposaviqit, 4 km në jug të qendrës. Shtrihet në brigjet e lumit Ibër, në lartësinë mbidetare 793 m, ndërsa nga ana lindore e rrethojnë malet deri në 1,200 m. Sipërfaqja e zonës kadastrale është 1,953 ha, nga e cila 71% është pyje dhe kullosa, kurse 29% ara dhe pemishte. Në bazë të gjetjeve arkeologjike dëshmohej se ishte vendbanim i njohur dardan me emrin “Municipium DD”, që, pas Ulpianës, paraqet lokalitetin më të rëndësishëm antik në Kosovë. Ky zhvillim lidhet me eksploatimin e xeheve në rrethinën e tij gjatë shekujve I deri IV të erës së re. Si vendbanim me emrin Selçanica përmendet në vitin 1315, pastaj në defterët osmanë dhe në hartat austriake. Në vitin 2011 kishte 1,296 banorë, ndaj 457 banorëve që kishte në vitin 1921. Pjesa më e madhe e banorëve është e përqendruar buzë Ibrit dhe merren me bujqësi, kurse disa lagje në kodrinat përreth merren me pemëtari dhe blegtori. (Përparim Gashi)

SOÇANICA. Shih: **MUNICIPIUM DD.**

SOJEVA Hivzi (1947-). Ekonomist, profesor universitar. Lindi në Sojevë të Ferizajt. Shkollimin fillor dhe të mesëm i mbaroi në Ferizaj, ndërsa Fakultetin Ekonomik në Prishtinë. Studimet e magjistraturës i kreu në Zagreb, disertacionin e mbrojti në Prishtinë. Në fillim punoi si mësimdhënës në arsimin e mesëm, pastaj në KK të Ferizajt, si drejtor i të hyrave shoqërore. Në vitin 1974 zgjidhet asistent në Universitetin e Prishtinës, ku vazhdoi të punojë deri në pensionim. Pas luftës ishte edhe drejtor i Entit të Statistikave të Kosovës. Publikoi disa punime shkencore në revistat e ndryshme në Kosovë dhe të ish-Jugosllavisë. Ishte bartës i projekteve shkencore dhe i studimeve hulumtuese lidhur me problematikën e ekonomisë kosovare të realizuara nga Instituti Ekonomik i Prishtinës.

Mori pjesë në disa kongrese dhe konferenca shkencore. Kontributi i tij është shtrirë veçmas në shqyrtimin shkencor të fushës së ekonomisë së tregtisë, të konsumit, të standardit jetësor të popullsisë dhe të masave të tjera nga fusha e politikës ekonomike. (Sinan Ademaj)

SOJEVA. Fshat në komunën e Ferizajt, 5 km në juglindje të qytetit. Është vendbanim fushor i tipit të grumbulluar, me sipërfaqe prej 987 ha dhe lartësi mbidetare 564 m. Mbi 60% e sipërfaqes është tokë bujqësore (ara dhe livadhe), 20% zë kampi ushtarak i KFOR-it dhe 17% pyje. Gjurmët arkeologjike në lindje të fshatit dëshmojnë për lashtësinë e këtij vendbanimi. Përmendet në defterin kadastral të vilajetit Vëllk të vitit 1445 me emrin Sivajeva, me 72 shtëpi. Pas masakrës serbe të vitit 1912, nga ky fshat shumë familje u shpërngulën për në Turqi, kurse në vend të tyre u vendosën kolonë serbë. Në vitin 2011 kishte 1,530 banorë, ndaj 365 banorëve në vitin 1921. Popullsia merret kryesisht me bujqësi, por numër i madh i tyre punojnë jashtë vendit. Tani njihet si zonë ushtarake e KFOR-it amerikan “Kampi Bondstil” (Camp Bondsteel). (Përparim Gashi)

SOKALNIKËT. Një kategori sociale e nënshtruar në prona feudale, në kohën e sundimit të Mbretërisë së Rashës, nga mesi i shek. XIII deri në mesin e shek. XIV, prejardhja e së cilës nuk është sqaruar plotësisht. Vetë termi edhe në filologjinë sllave të jugut është me prejardhje të paqartë. Në të vërtetë, fjala shënjonte katundarin (bujkun), i cili ishte i detyruar ta paguante tagrin e quajtur “soq” (soč). Nga shënimet në krisobulën e Banjskës (1313-1318) dhe në krisobulat e Deçanit (1330, 1335) mësohet se sokalnikët ishin kategori më vete sociale. Për këtë kategori kishte madje edhe një ligj të veçantë. Në krisobulat e Deçanit, në kontekstin që ka të bëjë edhe me sokalnikët, familjet e kryefamiljarëve pa djem ose pa vëllezër mund të bashkoheshin në një të vetme, në mënyrë që atyre të mos u binte shumë barrë pune. Kjo vlente edhe për gjahtarët me fajkua dhe për mjeshttrit. Sipas “Ligjit të sokalnikëve”, të sanksionuar në krisobulën e Deçanit, është shënuar shprehimisht se për Manastirin e Deçanit sokalnikë do të jenë 33 njerëz: në Deçan 3, në Beleg 1, në Prapaçan 6, në Isniq 1, në Strellc 3, në Luboliq 2, në Rostovicë 4, në Prilep 6, në Babaj 2 dhe në Gramaçel 5 sish. (Skënder Gashi)

SOKOLI Ali (1921-1974). Mjek, pneumoftiziolog, mësimdhënës universitar. Lindi në Rahovec. Kreu arsimin fillor në vendlindje, ndër-sa në Shkup kreu Medresenë e Madhe (1941).



ALI SOKOLI

Në vitin 1941 u regjistrua në Fakultetin e Bujqësisë në Pizza të Italisë, por me kapitullimin e Italisë u detyrua t'i ndërpresë studimet dhe u kthye në vendlindje. Në vitin shkollor 1944-1945 i vazhdoi studimet në Fakultetin e Bujqësisë në Vjenë, të cilat i ndërpreu sërish, për shkak të rrethanave të luftës. Më 1945 u kthye në Rahovec dhe bëri punë administrative në komunën e Rahovecit, më pas në Prishtinë. Kërkesa për të vazhduar studimet jashtë Kosovës në fushën e bujqësisë iu refuzua, por iu dha bursa për të studiuar mjekësinë në Universitetin e Beogradit. U diplomua në vitin 1951 dhe nisi punën në Prizren. Pas specializimit nga pneumoftiziologjia u transferua në Dispanserin e Tuberkulozit në Gjakovë, ku punoi për tri vjet. Më 1958 u vu në krye të repartit pulmologjik të Spitalit të Përgjithshëm në Prishtinë, të cilin e udhëhoqi për 16 vjet, deri në fund të jetës. Me hapjen e Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë ishte njëri prej arsimtarëve të parë të katedrës së sëmundjeve të brendshme, dega e pulmologjisë. Në vitin 1973 botoi një doracak për studentët e Fakultetit të Mjekësisë, “Pneumoftiziologjia” (1973). U vlerësua për punën dhe përpjekjet që bëri në luftën kundër tuberkulozit dhe sëmundjeve të tjera të mushkërive. Ishte bartës i shumë mirënjohjeve dhe dekoratave. Shkolla e mesme e mjekësisë në Prishtinë mban emrin e tij. Vdiq në vendin e punës, në moshën 52-vjeçare. (Isuf Dedushaj)

SOKOLI Bylbyl (1957-). Trajner. Lindi në Rahovec, ku kreu shkollën fillore dhe të mesme. Kreu në Prishtinë Fakultetin e Kulturës Fizike (1985), studimet pasuniversitare dhe mbrojtë tezën e doktoraturës (2003). Karrierën prej futbollisti e filloi në KF “Partizani” të Rahovecit e më pas vazhdoi edhe në skuadra të tjera të Kosovës. Profesionin e trajnerit të futbollit e nisi në vitin 1988 në skuadrën prishtinase “Ramiz Sadiku”, vazhdoi më pas në skuadra të tjera, si: “Flamurtari”, “2 Korriku”,

“Besëlidhja”, “Renova” (Tetovë), “Drenica”, “Hysi”, “Prishtina” etj. Ishte përzgjedhës i përfaqësueses së Kosovës, kurse tri herë është shpallur trajner i vitit. Në vitin 2004 është pajisur me certifikatën UEFA-s, kurse në vitin 2006 me diplomën e trajnerit të UEFA-s. Është ligjërues i lëndës së futbollit në Fakultetin e Shkencave Sportive të Universitetit të Prishtinës. (Baki Berisha)

SOKOLI Isuf (1820-1880). Veprimtar, luftëtar i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Lindi në Shkodër. Në administratën e Perandorisë Osmane ishte krahinar dhe kryetar i xhibalit, deri në vitin 1865. Në vitin 1870 u emërua nënprefekt në Lezhë. Mori pjesë si përfaqësues i Shkodrës në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit. Në tetor të vitit 1878 emërohet nënprefekt i Mirditës. Në periudhën vijuese ishte njëri ndër organizatorët e ndihmave për muhaxhirët që u dyndën në Shkodër, pas pushtimit nga Mali i Zi të Podgoricës, Shpuzës, Zhabjakut dhe Nikshiqit. Ishte iniciator i lëvizjes që u bë në Shkodër, për të dërguar ndihma për Plavën e Gucinë. U zgjodh në krye të 700 vullnetarëve të Shkodrës dhe luftoi për mbrojtjen e Plavës dhe të Gucisë (1879). Udhëhoqi forcat vullnetare për mbrojtjen e Ulqinit (nëntor 1880), ku u plagos rëndë. Vdiq pas 3-4 ditësh në Shkodër. (Alban Dobruna)

SOKOLI Mic (1839-1881). Prijës popullor i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Hero i Popullit. Lindi në Fang të Bujanit në Tropojë. Babai i tij, Sokol Rama, bashkë me axhën e tij, Binak Ali-



MIC SOKOLI

në, udhëhoqi kryengritjet kundër reformave të Tanzimatit. Ngjarje me ndikim në jetën e tij ishte vrasja e të atit nga forcat turke. I organizuar në çetat vendëse, përleshjen e parë me forcat turke e pati në moshën 15-vjeçare, në pritat ndaj postave e patrullave turke. Në vitin 1855 mori pjesë për herë të parë në luftime kundër forcave malazeze. U dëbua nga Malësia dhe u zhvendos në Kosovë, sepse fali gjakun pa pajtimin e parisë së fisit. U shqua shpejt për trimëri dhe u bë i njohur për disa funksionarë keqbërës turq në Prizren dhe Pejë. Për rrjedhojë, në moshën 19-vjeçare del në mal si pjesëtar i çetave të luftëtarëve. Ndërkohë, në Kosovë u njoh me

Sulejman Vokshin, Haxhi Zekën, Ymer Prizreni etj. Periudha e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit e gjeti prijës të Krasniqes dhe bashkë me Ali Ibrën u zgjodh udhëheqës i forcave të Malësisë së Gjakovës. Forcat e komanduara prej tij u transformuan në gardë dhe ai u caktua komandanti i Gardës së Lidhjes. Udhëhoqi njësitë e Lidhjes në shumë beteja, si në Gjakovë (shtator 1878), ku mbeti i vranë Mehmet Ali Pasha, i dërguari i Sulltanit për zbatimin e vendimeve të Kongresit të Berlinit. Më pas u shqua në mbrojtje të Plavës dhe Gucisë, si anëtar i shtabit të mbrojtjes të Lidhjes, dhe veçmas në Betejën e Nokshiqit (1880), në luftimet në afërsi të urës së lumit Lim, ku u shpartalluan forcat e Mark Milanit. Luftoi në mbrojtje të krahinave të Hotit, të Grudës dhe të Tuzit dhe më 1881 në luftimet për çlirimin e Shkupit (ku dhe u plagos), të Prizrenit, të Mitrovicës, të Vushtrrisë dhe të Gjilanit. Ishte pjesëtar i Shtabit të Lidhjes, me në krye Sulejman Vokshin, për mbrojtjen nga ekspedita ndëshkuese e Dervish Pashës. U dallua në betejat e Shtimes, të Cerralevës dhe të Slivovës. Në Slivovë, më 20 prill të vitit 1881, në krye të forcave për ndaljen e depërtimit të ushtrisë turke drejt Prizrenit, ra bashkë me disa bashkëlufetarë, në përpjekje për të neutralizuar një bateri artilerie të forcave turke. Emri i tij u kthye në legjendë nëpërmjet rrëfimeve dhe këngëve popullore. (Endrit Musaj)

SOKOLI Qemail (1950-). Organizator, producent. Lindi në Rahovec. Studimet për produksion të filmit dhe televizionit i mbaroi në Fakultetin e Arteve Dramatike në Beograd, ku kreu edhe studimet pasuniversitare dhe mbrojti tezën e disertacionit të doktoratës për historikun e zhvillimit të Teatrit Popullor Krahinor të Kosovës. Prej vitit 1976 punoi në Televizionin e Prishtinës, ku kreu detyra të organizatorit dhe producentit kryesor, si dhe të drejtorit të produksionit të TVP-së. U mor edhe me punë kërkimore shkencore dhe me shkrime publicistike. Ka shkruar dhe ka vënë në skenë dramën e tij, nga të cilat do përmendur drama “Bija e minatorit” (1994), të cilën e realizoi edhe si version televiziv. (Fadil Hysaj)

SOKOLOVA Bojka (1939-). Gjuhëtare bullgare, albanologe. Studioi në Universitetin e Sofjes dhe në Universitetin e Tiranës, ndërsa i përfundoi në Universitetin e Leningradit. Si punonjëse e Institutit të Ballkanologjisë në Sofje mbrojti disertacionin mbi dialektin shqiptar të

Mandricës. Me rëndësi është hulumtimi i saj mbi koloninë shqiptare në Bullgari “Shtypi i Rilindjes Shqiptare në Bullgari” (Albanski vrozhdenski pečat v Balgarija, Sofje 1979). Libri i dytë është një studim i hollësishëm mbi të folmen e fshatit Mandrica në Bullgarinë Juglindore, i botuar vetëm gjermanisht, në Berlin. Mori pjesë në Kongresin e Drejtshkrimit në vitin 1972. Ndër punimet e rëndësishme të saj janë ato për diftongjet e së folmes shqipe të Mandricës, për alfabetin e Sami Frashërit, për shqiptarët në letërsinë bullgare e kështu me radhë. Jeton në Zvicër, ku drejton kurse për gjuhën shqipe. (Anton Pançev)

SOLANA Javier (Javier) (1942-). Politikan spanjoll, sekretar i përgjithshëm i NATO-s në kohën e luftës në Kosovë. Lindi në Madrid. Kreu një shkollë të mesme katolike dhe studioi




HAVIER SOLANA

për fizikë. Në vitin 1964 fshehurazi u bë anëtar i Partisë Socialiste Spanjolle, e cila ishte nxjerrë jashtë ligjit nga Frankoja që në fund të luftës civile më 1939. Në atë periudhë bëri specializime shkencore përveç në Spanjë, edhe në Britani dhe SHBA. Në vitin 1975 u zgjodh profesor në Universitetin Complutense. Më pas mori pjesë në zhvillimet politike të asaj periudhe në Spanjë. Ishte ministër i Kulturës dhe më pas i Arsimit në qeverinë e Filipe Gonzalesit, pastaj zëdhënës i qeverisë dhe ministër i Jashtëm në vitin 1992. Në vitin 1995 u emërua Sekretar i Përgjithshëm i NATO-s. Emri i tij lidhet veçanërisht me luftën e Kosovës dhe me bombardimet e Aleancës kundër Serbisë. Pas dështimit që Konferenca e Rambujesë t'i jepte fund konfliktit në Kosovë, më 22 mars 1999, Këshilli i NATO-s autorizoi sekretarin e përgjithshëm për të vënë në veprim fazën e 2-të të sulmeve ajrore, duke e reduktuar kohën e veprimit në 24 orë. Në paraqitjet e tij publike, H. Solana arsyetoi sulmet ajrore me parandalimin e një krize humanitare përmasash të mëdha dhe të spastrimit etnik në Kosovë. U largua nga NATO-ja në tetor të vitit 1999 dhe u emërua Përfaqësues i Lartë për Politikën e Jashtme dhe Siguri të Bashkimit European. Në vitin 2004 u dekorua nga presidenti i Kosovës me “Medaljen e Artë të Lirisë”. (Valdrin Ukshini)

SOLANO Françesko (Francesco) (1914-1999). Gjuhëtar arbëresh, shkrimtar. Njihet në letërsi me emrin Dushko Vetmo. Lindi në Frasnitë, Kalabri. Studio për teologji në Itali dhe në Argentinë. Jetoi afro njëzet vjet në Amerikën Latine (Argentinë, Uruguai, Kili), për t'u kthyer sërish në Itali, duke punuar si prift në vendlindje. Ishte ndër themeluesit e katedrës së shqipes në Universitetin e Kozoncës, të cilën e drejtoi për disa vjet rresht. Publikoi gramatikën “Doracak i gjuhë shqipe” (Manuale di lingua albanese) më 1972 dhe shumë artikuj studimorë për të folmet arbëreshe. Themeloi edhe revistën “Zjarri” më 1973. Botoi vepra letrare: prozë, poezi e dramë. Që më 1947 botoi vëllimin e parë me poezi “Bubuqe tëgra”, më pas tri drama, më vonë përmbledhjen “Tregimet e lëmit” etj. Ishte pjesëmarrës në Seminarin Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, duke sjellë me vete edhe studentët e tij nga Universiteti i Kozoncës. (Imri Badallaj)

SOPAJ Nehas (1954-). Shkrimtar, përkthyes, mësimdhënës universiteti. Lindi në Sllupçan të Kumanovës. Shkollën fillore e kreu në Opajë, të mesmen në Kumanovë, kurse studimet për



NEHAS SOPAJ

gjuhë dhe letërsi shqipe në Shkup. Studimet pauniversitare i kreu në Prishtinë, ndërsa u doktorua në Shkup (1994). Në periudhën 1977-1979 ishte përkthyes në gazetën “Flaka”, kurse nga viti 1979 është profesor në katedrën e albanologjisë në Shkup. Është autor i disa librave letrarë, studimorë dhe universitarë. Ka botuar përmbledhjet poetike: “Këngët e blerta” (1973), “Algje” (1973), “Të fala prej hënës” (1975), “Në rreth” (1979), “Gjysmëhëna” (1980), “Himeret e harbuara” (1988), Algjet (shqip, maqedonisht, 2004), “Energjia negative” (2006) etj. Është autor i librave me tregime dhe novela: “Gjëmat e gjemisë” (1985), “Letër Lirijes” (1987), “Në fund të Akeronit” (1993) dhe i romaneve: “Fluturimi mbi Sllupçan” (1997), “Rruga e garforres” (2000) dhe “Unaza e humbur” (2003). Ka botuar librat me studime letrare: “Paralelet letrare” (1998), “Rrëfimi në romanin monologjik shqiptar” (1994), “Shpalimi i herbariumit” (2008), “Individualitete letrare” (2008,

2014). Ka përkthyer në gjuhën shqipe disa vepra letrare. Është fitues i disa çmimeve për letërsi. (Salajdin Salihu)

SOPI Agim (1957-). Regjisor, skenarist, producent. Lindi në Smallushë të Lipjanit. Kreu studimet për regji filmi në Akademinë e Arteve Dramatike të Universitetit të Zagrebit.



AGIM SOPI

Bëri karrierë në teatër dhe kinematografi. Si regjisor teatri realizoi mbi një sërë shfaqjesh, nga të cilat veçohen: “Gof” e A. Pashkut në Teatrin Amator të Ferizajt (pjesëmarrës në Festivalin e teatrove eksperimentale në

Beograd, 1980), pastaj shfaqjet e realizuara në Teatrin Popullor Krahinor (TPK): “Trungu Ilir” sipas vargjeve të S. Hamitit (pjesëmarrës në Festivalin e Sarajevës, MESS, 1981), “Izraelitë dhe filistinë” të F. S. Nolit, “Princi i hijeve” të M. Krajës, “Varreza për Boris Davidoviçin” të D. Kishit (e realizuar me dramën serbe në TPK, shfaqje që i mori 6 çmime në Takimet “Joakim Vujiq” në Kragujevc të Sërbisë 1986), pastaj shfaqjet “Teatri i vogël i Deli Ukës” të Y. Shkrelit, “Gjërat që s’preken” sipas vargjeve të Rr. Dedajt, “Antigona” e Sofokliut, “Doktor Faustus” të K. Marlosë, “Motra e katërt” të J. Glowackit, “Kutia e zeze” e S. Hamitit, “Dosja H” e I. Kadaresë, të gjitha këto shfaqje të punura në Teatrin Kombëtar të Kosovës. A. Sopi realizoi shfaqje edhe në tetarot e Shkupit, Tiranës (“Bregu i pikëllimit”), Gjakovës (“Pirro”), Prizrenit (“Im atë e donte Adolfin”), në teatrin e Tetovës etj. Në fushën kinematografike Agim Sopi u bë i njohur me filmin e tij të parë të metrazhit të gjatë: “Njeriu prej dheu” (1984) me të cilin mori çmimin “Amone Re Award” në Festivalin Ndërkombëtar të Filmit në Kajro (1989), pastaj vazhdoi me filmat “Vjeshta e trëndafileve” (2000), “Anatema” (2005), i cili ka qenë pjesë e programeve zyrtare në shumë festivale ndërkombëtare. Ndërsa me filmin e fundit “Agnus Dei” (2012) mori pjesë në shumë festivale dhe fitoi shumë çmime kinematografike, si në festivalin e Amsterdimit, në festivalin e Londrës, në Salento të Italisë, në festivalin e Kalifornisë, në Bagdad etj. A. Sopi realizoi edhe filmat televizivë: “Pelerina” (1982), “Lulepjeshkat e

dashurisë” (1988), dhe “Kulla” (1990) si dhe filmat dokumentarë: “Pritja” (1980), “Rojet e mesnatës” (1981), “Përtej vdekjes” (2000) etj. Zhvillon edhe veprimtari prej producenti në kuadër të kompanisë së tij “AS Film Production”. Më 2015 u zgjodh drejtor i Teatrit Kombëtar të Kosovës, ndërsa në Fakultetin e Arteve në Universitetin e Prishtinës ligjëron teorinë e filmit. (Fadil Hysaj)

SOPI Ipeshkëv Mark (1936-2006). Ipeshkëv i Kosovës, studiues. Lindi në Binçë, shkollën fillore e kreu në Viti, ndërsa gjimnazin në Pazin të Kroacisë. Fakultetin e filloi në Zagreb, ku i



IPESHKËV MARK SOPI

kreu dy vjet të filozofisë dhe më pas i vazhdoi në Romë. U shugurua meshtar në Romë më 1968 dhe u emërua famullitar në Ferizaj, si dhe iu besua detyra e sekretarit të ipeshkëvit, imzot Nikë Prelës. Në vitin 1974 u emërua

famullitar në Zllakuqan, ku qëndroi deri në vitin 1991, kur u emërua famullitar në Durrës. Në nëntor të vitit 1995, Selia e Shenjtë e emëroi ipeshkëv të Kosovës. Për shkak të rrethanave në Kosovë, u shuguruar për ipeshkëv në Romë në janar të vitit 1996 nga Papa Gjon Pali II. Për t’u njohur më mirë me problemet e brendshme të shtetit të ri të Kosovës, imzot Sopi u ftua në Amerikë, së bashku me dom Lush Gjergjin (2005) për të dëshmuar para Kongresit Amerikan për Kosovën në prag të Shpalljes së Pavarësisë. Imzot Sopi njihet edhe në fushën e botimeve me veprat: “Baca Kolë dhe famullitari” (1995), “Martirët e Karadakut” (1996), “Koncilët ekumenikë” (2000) etj. (Ndue Ukaj)

SOPI Ismet (1957-). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), gazetar. Lindi në Runik të Skënderajt. Punoi si mësues në Arllat. Në vitin 1981 ishte njëri nga organizatorët e demonstratave në Drenas. Pas demonstratave u arrestua dhe në gusht të atij viti u dënua me 14 vjet burg, si pjesëtar i Lëvizjes Nacionalçlirimtare. Pasi vuajti 9 vjet burg, u lirua në vitin 1990, me rastin e amnistisë së përgjithshme. Me fillimin e luftës në Kosovë, pas rënies së komandantit legjendar Adem Jashari dhe familjes së tij u inkuadrui në radhët e UÇK-së, ku

kreu detyrën e reporterit të luftës për Radio-televizionin Shqiptar. Deri në përfundimin e luftës qëndroi në malet e Berishës. Gjatë asaj kohe raportoi edhe për Radion “Kosova e lirë” dhe Agjencinë e lajmeve “Kosovapress”. Bashkëpunoi edhe me gazetarë dhe reporterë të huaj dhe me agjenci të ndryshme të lajmeve. Pas luftës punoi në gazetën “Rilindja” dhe në “Radio Rilindja”, ndërsa më pas udhëhoqi radion e pavarur “Radio Drenasi”. (Ruzhdi Jashari)

SOPI Lumnie (1967-). Aktore. Lindi në Kabash të Prizrenit. Kreu studimet për gjuhë dhe letërsi angleze në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës, ndërkaq specializimin njëvjeçar



LUMNIE SOPI

për Aktrim në “Redman Studio” në Londër. Karrierën artistike e filloi në moshën 15-vjeçare me filmin artistik “Lepuri me pesë këmbë” (1982) me regji të Ismail Ymerit. Më pas, gjatë viteve ’80 dhe fillimit të viteve ’90 luajti kryesisht rolet kryesore në shfaqje të ndryshme në Teatrin Popullor Krahinor, si: “Israelitë dhe Filistinë”, “Ifigjenia në Aulidë”, “Antigona”, “Bregu i pikëllimit”, “Tragjedia e dr. Faustit”, “Shënimet e Gjon Nikollë Kazazit”, “Viktimat e Tivarit” etj. Pas vitit 2000 në Teatrin Kombëtar të Kosovës luajti role të ndryshme në shfaqjet: “Muzgu i lirisë”, “Motra e katërt”, “Lidhje gjaku”, “Dosja H”, “Një varr për Majorin e Mbretit” etj. Në Teatrin Shqiptar të Shkupit luajti në shfaqjen “Kush e vrau Edgar Allan Po-në”. Përveç në teatër, luajti edhe në disa filma të metrazhit të gjatë, si: “Njeriu prej dheu”, “Anatema”, “Agnus Dei”, “Prilli i thyer” etj., dhe në filmat televizivë: “Nën qarr po rrinte vasha” (1985), “Lulepjeshkat e dashurisë” (1990), “Kulla” (1991). (Naime Beqiraj)

SOPI Rudolf (1933-1984). Xhirues, drejtor i fotografisë. Lindi në Prizren. Shkollën fillore e të mesme i mbaroi në vendlindje, ndërsa studimet për kamerë në Akademinë e Filmit në Zagreb. Punoi në redaksinë shqipe të TV Beogradit. Më 1968 u punësua si xhirues filmik në Radiotelevizionin e Prishtinës. Fillimet e karrierës i nisi në bashkëpunim me regjisorin Ekrem Kryeziu, kurse punën e tij e vazhdoi me regjisorin Besim Sahatçiu. Ishte drejtor fotografie e operator i filmit dhe teleserisë “Era dhe



RUDOLF SOPI

Lisi” (1978) dhe “Tre vetë kapërcejnë malin”. Për filmin “Pikë e gurë” u shpërblye me medaljen e artë në Festivalin e Filmit Dokumentar në Beograd. Xhironi edhe filmat dokumentarë: “Duke pritur Godonë, “Shtënia në ajër”, “Dita e mërgimtarëve”, “Ditari i Lec Pazheci”, pastaj serialin “Druri” etj. Ishte pionier i kamerës e mësues i shumë brezave të xhiruesve në TV Prishtinë. Xhironi dhjetëra dokumentarë dhe shumë shfaqje teatrore për televizionin. Ishte drejtor i fotografisë në filmin e parë artistik të Ekrem Kryeziut “Të ngjuarit”. Me punën e tij inventive u bë sinonim i xhiruesit të suksesshëm, inventiv dhe të përkushtuar. RTK-ja tradicionalisht e jep çmimin për xhiruesin më të mirë televiziv me emrin e tij. (Gani Mehmetaj)

SOPI Tahir (1981-). Gazetar i sportit. Lindi në Prishtinë, ku kreu shkollën fillore dhe të mesme, kurse u diplomua në Fakultetin e Shkencave Sportive në Prishtinë. Në gazetarinë sportive u përfshi prej vitit 2000 si gazetar i gazetës sportive në atë kohë “Kosova sport”. Pjesë e redaksisë së kësaj gazete ka qenë deri në vitin 2004, kur kaloi te e përditshmja “Kosova sot”. Po atë vit, disa muaj më vonë, kaloi te e përditshmja “Koha ditore”. (Baki Berisha)

SOS FSHATRAT E FËMIJËVE. Fondacioni “SOS Fshatrat e Fëmijëve” në Kosovë vepron nga viti 1999. U ofron strehim, përkujdesje sociale dhe edukim fëmijëve të braktisur dhe në nevojë. Mbështetet nga donacione, sponsorizime e financime të ndryshme. Është organizatë joqeveritare, e cila veprimtarinë e saj e zhvillon nëpërmjet projekteve, siç janë: Qendra “Dielli”, “SOS Familja”, “SOS Qendra Rinore”, Programi “Fuqizimi i Familjes”, “SOS-Kopshti i Ri”, Qendra Këshilluese dhe Përkrahëse për Fëmijë dhe Familje në Rrezik etj. Në këto institucione janë përfshirë më shumë se 1,000 fëmijë kosovarë, me përkatësi të ndryshme kombëtare. (Majlinda Gjellaj)

SPAHIJA Halim (1897-1946). Veprimtar i Lëvizjes Nacional Demokratike Shqiptare (LNDSH). Lindi në Gjakovë, ku mori edhe

arsimin fillor. Ishte njëri nga themeluesit e LNDSH-së kur u zgjodh kryetar i Komitetit Qendror të LNDSH-së (7 dhjetor 1943). Ishte delegat i Gjakovës në kuvendin themelues të Lidhjes së Dytë të Prizrenit. Pas lufte u inkuadrua në organet e pushtetit. Në vitin 1945 u zgjodh kryetar i parë i Këshillit Nacionalçlirimtar (KNÇ) të rrethit të Prizrenit dhe anëtar i Këshillit Nacionalçlirimtar të Kosovës. Në Konferencën e Këshillave Popullore të Rretheve të Kosovës, mbajtur më 19-24 mars 1945 në Prishtinë, iu kundërvu aneksimit të Kosovës nga Republika e Serbisë. Ishte anëtar i delegacionit të parë të shqiptarëve të Kosovës në takim me Josip Broz Titon, më 4 prill 1945, ku shtroi kërkesën për realizimin e vendimeve të Rezolutës së Bujanit. Për shkak të veprimtarisë atdhetare u shkarkua nga posti i kryetarit të KNÇ të Rrethit të Prizrenit. Edhe pse ishte shtetas i Shqipërisë, në qershor të vitit 1945 u ekstradua nga shteti shqiptar dhe më 27 shtator 1945 u akuzua për “tradhti ndaj popullit dhe atdheut”. Gjykata e Prizrenit e dënoi me pushkatim. U pushkatua më 16 shkurt 1946 në Prishtinë. (Sulltane Ukaj)

SPAHIJA Xhevdet (1950-). Piktur. Lindi në Pejë, ku kreu Shkollën e Mesme të Artit. U diplomua së pari në degën e artit figurativ në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prishtinë, ndërsa më 1982 kreu Akademinë e Arteve. Hapi ekspozita të pavarura në Prishtinë (Instituti Albanologjik, 2005; Galeria e MKRS, 2006 dhe 2012), pastaj në Pejë (2007, 2009, 2015), në Gjakovë (2011, 2014), në Geteborg të Suedisë (2011), në Tiranë (Muzeu Historik, 2013) dhe në Pogradec (2015). Është aktiv në ekspozitat kolektive të realizuara nga Shoqata e Artistëve Figurativë të Pejës, si dhe në ato që u hapën në Gjakovë, ku jeton dhe punon si pedagog i artit figurativ, pastaj në Poloni, në Zarë të Kroacisë, Suedi etj. (Rexhep Ferri)

SPAHIU Afrim (1951-). Kameraman, drejtor fotografie, mësimdhënës. Lindi në Dibër, ku kreu shkollën fillore dhe të mesme. Kreu Akademinë e Teatrit, Filmit dhe Televizionit në Universitetin e Zagrebit. Ishte xhirues në Radiotelevizionin e Prishtinës, drejtor fotografie në “Kosova-film”. Ligjëroi lëndën e fotografisë në Fakultetin e Arteve në Prishtinë dhe në Universitetin e Tetovës. Punoi si drejtor fotografie, manaxhues dhe realizues i disa projekteve ar-



AFRIM SPAHIU

tistike dhe komerciale, fotografi për katalogë, kalendarë dhe prezantime në media. Është themelues i Institutit të Fotografisë dhe i Filmit “Gjon Mili” në Prishtinë. Kuroi Ekspozitën ndërkombëtare të fotografisë artistike “Gjon Mili”, edicioni V, në Galerinë Kombëtare të Arteve në Prishtinë. Ishte drejtor fotografie në filma artistikë: “Gjurmë të bardha”, “Lepuri me pesë këmbë”, “Përroi vërsues”, “Proka”, “Kolonel bunker”, “Lule të kuqe, lule të zeza”, “Trishimi i zonjës Shnajder”, “Anatema”, “Gomarët e kufirit” dhe i filmit të shkurtër “Banka”. Nga filmat dokumentarë, të cilët i xhiron ai, veçohen: “117”, “Dita e mërgimtarëve”, “Shota”, “Gjyshi”; “Loja e rufaive”, “Duke pritur Godonë”, “Me arbëreshët e Italisë”, “Ah, Xho”. Është laureat i çmimeve të para për fotografinë e filmave artistikë “Kolonel Bunker” dhe “Lule të kuqe, lule të zeza” në festivalet e filmit shqiptar në Tiranë. (Gani Mehmetaj)

SPAHIU Ahmet (1932-2014). Aktor. Lindi në Pejë. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje. Në Teatrin Popullor Krahinor në Prishtinë luajti prej vitit 1956. Luajti role të



AHMET SPAHIU

ndryshme në një mori shfaqjesh të autorëve vendorë dhe të huaj, si: “Zonja ministreshë”, “Bashkëshortët”, “Dy metelike”, “Ditari i Ana Frankut”, “Hakmar-rja”, “Vrraga” “Shpirtnat”, “Hanka”, “Cubat”, “Familja e pikëlluar”, “Ushitari i mirë Shvejk”, “Matura”, “Kurtha për njeriun pa shpëtim”, “Autobiografia”, “Tri ditët e kiametit” “Kurtha”, “Zullumqari”, “Peripeçitë e kohës”, “Jehona 60”, “Profesori Mamlllok”, “I ndjeri”, “Paradoksi i Diogjenit”, “Erveheja”, “Fosilet”, “Otello”, “Duart e papastra”, “Halili e Hajria”, “Zonja me kamelië”, “Antigona”, “Duke pritur Godonë”, “Kaligula”, “Përkoljinajt”, “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”, “Revizori”, “Golgota”, “Besa e madhe”, “Një nuse për Stasin”, “Ana Karenina”, “Beselam pse më flijojnë”, “Varri i qyqes”, “Princi i hijeve”, “Vdekja më vjen prej syve të tillë” etj. Luajti edhe në disa

tistike dhe komerciale, fotografi për katalogë, kalendarë dhe prezantime në media. Është themelues i Institutit të Fotografisë dhe i Filmit “Gjon Mili” në Prishtinë. Kuroi Ekspozitën ndërkombëtare të fotografisë artistike “Gjon

Mili”, edicioni V, në Galerinë Kombëtare të Arteve në Prishtinë. Ishte drejtor fotografie në filma artistikë: “Gjurmë të bardha”, “Lepuri me pesë këmbë”, “Përroi vërsues”, “Proka”, “Kolonel bunker”, “Lule të kuqe, lule të zeza”, “Trishimi i zonjës Shnajder”, “Anatema”, “Gomarët e kufirit” dhe i filmit të shkurtër “Banka”. Nga filmat dokumentarë, të cilët i xhiron ai, veçohen: “117”, “Dita e mërgimtarëve”, “Shota”, “Gjyshi”; “Loja e rufaive”, “Duke pritur Godonë”, “Me arbëreshët e Italisë”, “Ah, Xho”. Është laureat i çmimeve të para për fotografinë e filmave artistikë “Kolonel Bunker” dhe “Lule të kuqe, lule të zeza” në festivalet e filmit shqiptar në Tiranë. (Gani Mehmetaj)

ndryshme në një mori shfaqjesh të autorëve vendorë dhe të huaj, si: “Zonja ministreshë”, “Bashkëshortët”, “Dy metelike”, “Ditari i Ana Frankut”, “Hakmar-rja”, “Vrraga” “Shpirtnat”, “Hanka”, “Cubat”, “Familja e pikëlluar”,

filma të metrazhit të gjatë, si: “Era dhe lisi”, “Kur pranvera vonohet”, “Heroi” etj., si dhe në serialin televiziv “Familja moderne”. U nderua me çmimin kombëtar për vepër jetësore (2012) nga Ministria e Kulturës e Kosovës. (Naime Beqiraj)

SPAHIU Avni (1956-). Gazetar, përkthyes. Lindi në Mitrovicë. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Mitrovicë dhe SHBA, ndërsa studimet për gjuhë dhe letërsi angleze në Uni-



AVNI SPAHIU

versitetin e Prishtinës. Për shumë vjet punoi gazetar i së përditshmes “Rilindja”, reporter, korrespondent në Nju-Jork, redaktor dhe kryeredaktor i “Rilindjes” (“Bujku”) në periudhën 1994-1998. Ishte kryeredaktor dhe drejtor i Televizionit të Kosovës (2000-2005) dhe i Radio Kosovës (2005-2008). Gjatë vitit 1990 ishte bashkëthemelues dhe veprimtar i Këshillit për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut në Prishtinë. Gjatë kësaj kohe hartoi dhe përgatiti raporte, analiza dhe parashtrësia për shkeljet e të drejtave të njeriut në Kosovë. Një kohë ishte këshilltar dhe bashkëpunëtor i presidentit Ibrahim Rugova në udhëtimet dhe takimet diplomatike. Është autor i disa librave nga fusha e publicistikës: “Fan Noli - Jeta në Amerikë” (2005, anglisht 2009), “Nobelistet e letërsisë” (2007), “Skica amerikane” (2015). Përktheu një sërë librash nga lëmi i letërsisë dhe nga fushat e tjera, si “Anatomia e letërsisë” e Francis Fergusonit, “Majat e Shalës” e Rose Wilder Lane (1994), “Pajtimi - Islami dhe Perëndimi” i Benazir Butos etj., përfshirë edhe përmbledhjet e poezisë shqipe në anglisht “Eni vjen nga Çamëria” (2005), “Guri i çarë” (2006), “Mësomë të dua” (2007). Përktheu në shqip poezi nga poetë britanikë dhe amerikanë. Ishte ambasadori i parë i Republikës së Kosovës në Uashington (2018-2014), pastaj ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiptotë i Republikës së Kosovës në Ankara. (Ibrahim Berisha)

SPAHIU Fatmir (1981-). Aktor, producent. Lindi në Bijello Polje në Mal të Zi. Shkollën fillore e filloi në Beograd, ndërkaq e përfundoi në Gjilan. Shkollën e mesme e kreu në Gjilan.



FATMIR SPAHIU

Studimet për aktrim i kreu në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. Në Teatrin Kombëtar të Kosovës ka luajtur në shfaqjet: “Fausti III”, “Arushani & Fejesa”, “Togeri nga Inishmori”, “Muzgu i lirisë”, “Ruleti ballkanik”, “Rikardi III”, “Motra e katërt” dhe “Nora”. Në Teatrin “Dodona” ka luajtur në shfaqjet: “Profesor jam talent se jo mahi, 5”, “Zoti kryetar, një gotë eks për seks”, “Galani”, “Hajnat nuk vijnë gjithmonë për të keq”, ndërkaq në Teatrin e Gjilanit në shfaqjet: “UN Inspektor” dhe “Sex, rrena dhe patat e egra”. Me role të ndryshme e gjejmë si aktor edhe në shfaqjet e Teatrit “Oda”, si: “Tre gjermanët e trashë” dhe “Mundësitë”, si dhe në shfaqjet e Qendrës Multimedia: “Mësimi i ndaluar”, “Mbreti dhe biri i tij Naku”, “Vëllezërit Shishmaku” etj. Përveç në teatër, ka luajtur edhe në filmat e metrazhit të gjatë: “Kukumi”, “Anatema”, “Djemtë e Rrugës Marks dhe Engels”, “Engjëjt janë larg”, si dhe në filmat e metrazhit të shkurtër: “Bingo”, “Piktura”, “Teatri i kukullave”, “Mesazhi”, “Ashensori”, “Kaseta e dasmës” etj. Njihet edhe si aktor i serialeve televizive vendore: “Kafeneja jonë”, “Familja moderne” etj. Është producent i filmit të metrazhit të gjatë “Engjëjt janë larg”. (Naime Beqiraj)

SPAHIU Irfan (1937-). Mjek, ftiziolog, profesor universiteti. Lindi në Kalesjan, Kukës, Shqipëri. Arsimin fillor e kreu në vendlindje dhe Prizren, kurse gjimnazin në Prishtinë.



IRFAN SPAHIU

Studimet i mbaroi në Fakultetin e Mjekësisë në Shkup (1967). Pas diplomimit u punësua në fshatin Grupçinë të Tetovës, më pas në Shkup dhe në Prishtinë. Kreu specializimin në lëmin e pneumoftizologjisë në Universitetin e Beogradit, ku njëkohësisht vijoi edhe studimet pasuniversitare. Mbrojti disertacionin e doktoratës në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë (1978). Në vitin 1974 u zgjodh asistent, më pas docent, profesor inordinar dhe më 1990 mori titullin profesor ordinar i lëndës pneumoftizologjia në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. Punoi

në Klinikën për Sëmundje të Mushkërive në Prishtinë për 34 vjet. Ishte drejtor i Klinikës për më shumë se 25 vjet. Është autor i tekstit universitar “Pneumofiziologjia” për studentët e mjekësisë dhe të stomatologjisë. Mori pjesë në shumë kongrese e simpoziume dhe publikoi një numër të konsiderueshëm të punimeve profesionale e shkencore. Në disa mandate ishte kryetar i Shoqatës së Pneumofiziologëve të Kosovës. (Halil Ahmetaj)

SPAHIU Islam (1838-1928). Udhëheqës popullor i krahinës së Lumës kundër pushtuesve osmanë dhe serbë. Lindi në Kolesjan të Lumës (Kukës). Udhëhoqi çetën e lumjanëve në luftërat kundër Sinan Pashës (1893), Shemi Pashës (1903/4-1906), Xhavit Pashës (1909), Shefqet Dërgut Pashës (1910), si dhe kundër ushtrisë serbe në nëntor të vitit 1912. Ishte pjesëmarrës në Kuvendin e Ferizajt (1908) dhe në mbledhjen e krerëve shqiptarë po në Ferizaj (7 prill 1910). I priu lumjanëve në kryengritjen e shtatorit të vitit 1913 kundër forcave serbe. Me nismën e tij u hap shkolla e parë shqipe në Kolesjan më 11 tetor 1911, nga i biri Riza Spahiu. Njihet posaçërisht për qëndresën kundër ushtrive serbe më 1919-1921. U ftua të merrte pjesë në Kongresin e Lushnjës, si delegat i Lumës, por nuk shkoi për shkak kryengritjes në Kosovë. Përkrahu Bajram Currin, Hasan Prishtinën dhe më vonë Avni Rrustemin në Asamblenë Kushtetuese (dhjetor 1923). Vdiq në Kolesjan. (Skënder Lutfiu).

SPAHIU Naim (1978-). Pikturor. Lindi në Mitrovicë. Kreu shkollimin fillor në vendlindje dhe në Skënderaj, ndërsa studimet i mbaroi në Fakultetin e Arteve në Prishtinë. Pas studimeve u zgjodh koordinatori për ekspozita në Galerinë Kombëtare në Prishtinë. Është piktor produktiv dhe ka hapur disa ekspozita individuale: në “Artqendra” të Fakultetit të Arteve (2002), te “Hani i 2 Robertëve” (2005) dhe në Galerinë e Ministrisë së Kulturës në Prishtinë, pastaj në Qendrën e Kulturës në Mitrovicë. Më 2007 hapi ekspozitë në Bibliotekën e Qytetit dhe në kampusin universitar në Vaksjo të Suedisë. Mori pjesë edhe në një numër ekspozitash kolektive brenda dhe jashtë vendit. Për punën krijuese mori disa çmime: çmimin e parë për pikturë në “Flaka e Janarit”, Gjilan (2006), çmimin e parë për pikturë në Galerinë e Arteve në Prishtinë (2007) si dhe çmimin e parë në “Arti global” në Prishtinë (2010). (Bislim Aliu)

SPAHIU Nexhmedin (1964-). Gazetar. Lindi në Mitrovicë. Kreu studimet për matematikë në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore të Universitetit të Prishtinës. Më 1987/88 ishte udhëheqës studentor i Universitetit të Prishtinës, kurse më 1988/89 koordinatori i udhëheqësve studentorë të ish-Jugosllavisë. Si nxënës dhe student u mor edhe me enigmatikë. Gjatë viteve '90 ishte bashkëpunëtor në dy gazetatat e Tiranës “Koha jonë” dhe “Albania”. Më 1999 themeloi Radiotelevizionin e Mitrovicës. Ka mbajtur ligjërata nga fusha e matematikës dhe e shkencave politike në universitetet e vendit dhe të huaja. Është autor i disa librave publicistikë: “Ekuilibret shqiptarë” (1997), “Shqiptarët dhe serbët në luftën finale për Kosovën” (1998), “Drejt protektoratit ndërkombëtar në Kosovë” (1998), “Drejt kombit kosovar” (2004), “Kombi në inkubator” (2010) etj. (Ibrahim Berisha)

SPAHIU Sabrije (1960-). Balerinë, mësime-dhënëse e baletit. Lindi në Mitrovicë, ku kreu nivelin e ulët të shkollës së baletit. Në vitin 1978 u diplomua në Qendrën e Baletit dhe të Operas në Shkup, ndërsa në vitin 1979 zë punë në Teatrin Popullor Krahinor (TPK) të Prishtinës, përkatësisht në trupën e baletit si anëtare e rregullt e këtij ansambli. Në vitet '80 luajti pothuajse në të gjitha shfaqjet e rëndësishme të baletit



SABRIJE SPAHIU

të vendosura në skenë në TPK: “Halili e Hajrija”, “Bolero”, “Shtrausiada”, “Sizif”, “Pjetër Pani”, “E bukura More”, “Dasma”, “Balloja e kadetëve”, “Bukuroshja e fjetur”, “Nusja” etj. Pas konsolidimit të sërishëm të ansambllit të baletit në vitin 1999 në Teatrin Kombëtar të Kosovës u paraqit në rolin e Princeshës në baletin “Princesha dhe katër kavalierët” dhe më vonë edhe në baletin “Fyelltari”. Krahas angazhimit të saj të rregullt në ansamblin e baletit, më 2003 themeloi në Prishtinë studion e baletit “Mjellmat”, ku punon si mësime-dhënëse e baletit me fëmijë të moshave të ndryshme. Është autore e librit “Fillet e para në baletin klasik” (2015). (Besim Rexhaj)

SPAHIU Safet (1960-). Dizajner. Lindi në Prizren. Kreu studimet për dizajn grafik në

Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës (1985). Është ligjërues i dizajnit grafik në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Tetovës. Ishte edhe dekan i këtij fakulteti. Krijimtaria e tij artistike kohët e fundit përfshin artin digjital, fotografinë dhe dizajnin si kombinim. Realizoi disa ekspozita personale dhe mori pjesë në shumë ekspozita kolektive brenda dhe jashtë vendit (Maqedoni, Kosovë, Shqipëri, Francë, Gjermani, Bullgari, SHBA etj.), ku mori edhe disa çmime. (Zeni Balazhi)

SPAHIU Sali (1946-). Inxhinier i arkitekturës. Lindi në Tiranë, shkollimin fillor e të mesëm i kreu në Gjakovë, ndërsa studimet në Fakultetin e Arkitekturës të Universitetit të Sarajevës (1973). Punoi në byronë projektuese të kombinatit ndërtimor “Ramiz Sadiku” (1973), në Entin Urbanistik të komunës së Prishtinës (1974) dhe në Entin për Urbanizëm dhe Projektme (1975-2011). Veprimtaria e tij profesionale përfshin kryesisht urbanizmin dhe enterierin. Kreu projektet arkitektonike të objekteve të PTT-së në Vushtrri, Viti, Kaçanik, bëri rikonstruktimin e Rektoratit të Universitetit të Prishtinës, të “Kosovafilmit”, të Qendrën tregtare “Kodra e Diellit”, të objekti komercial në “Fshatin ndërkombëtar”, të kompleksin banesor-afarist “Lesna”, të vendkalimin kufitar në Gllaboçicë etj. Është laureat i çmimeve profesionale të Shoqatës së Artistëve Aplikativë të Kosovës (1982) dhe i çmimit tradicional për arkitekturë në ish-Jugosllavi të gazetas “Borba” për objektin e “Kosovafilmit” (1987) etj. Ka marrë pjesë në një sërë ekspozitash kolektive brenda dhe jashtë vendit. Në librin “Arkitektura e Jugosllavisë 1945-1990” të autorit Ivan Shtraus (1991) është i prezantuar si autor nga Kosova me objektin e “Kosovafilmit”. (Dervish Qerreti).

SPAHIU Seniha (1936-). Pedagoge, studiuese e edukimit muzikor. Lindi në Prishtinë, mësimet për muzikë i mori në Shkup, ku kreu dhe studimet nga pedagogjia muzikore. Kreu studimet e magjistraturës në Akademinë e Muzikës në Beograd për metodikë të mësimt të muzikës. Ka përvojë pedagogjike 50-vjeçare në të gjitha nivelet arsimore. Ishte mësimdhënëse në shkollën fillore “Liria” në Prishtinë dhe drejtuese e korit të shkollës, më pas profesore e metodikës së muzikës në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prishtinë, më pas në Fakultetin e Arteve si



SENIHA SPAHIU

ligjëruese, pastaj docente dhe profesore nga viti 1987. Pas pensionimit (1991) vazhdoi punën në Fakultetin e Arteve dhe më 2002 u emërua “Profesore Emeritus”. Organizoi dhe udhëhoqi studimet pasuniversitare në periudhën 1998-2011. Është bashkautore dhe autore e teksteve për parashkollorë dhe e teksteve të muzikës për disa klasë të shkollës fillore, si dhe autore e tekstit universitar “Metodika e mësimt të muzikës” (2009). Është marrë me studime kërkimore-profesionale për çështjet nga fusha e mësimdhënies së muzikës, që përfshijnë një sërë punimesh si dhe këngë korale dhe për fëmijë. Publikimet e saj profesionale janë botuar në revista të ndryshme profesionale-shkencore. Është anëtare e Shoqatës së Kompozitorëve të Kosovës (nga 1980) dhe kryesoi Shoqatën e Pedagogëve Muzikorë të Kosovës. (Besa Luzha)

SPAHIU Shaip (1819-1881). Njëri ndër organizatorët dhe udhëheqësit e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Luftoi edhe për mbrojtjen e Ulqinit, Plavës e Gucisë dhe të tokave të tjera shqiptare, kundër aneksimit nga Mali i Zi dhe Serbia. Bënte pjesë në krahun radikal të Lidhjes dhe në maj të vitit 1880 u zgjodh nënkryetar i qeverisë së përkohshme dhe kryetar i degës së Lidhjes për qytetin e Prizrenit. Në të njëjtën kohë ishte emëruar edhe mytesarif i sanxhakut të Prizrenit. Ishte ndër organizatorët dhe udhëheqësit e qëndresës së armatosur kundër ushtrisë osmane të udhëhequr nga Dervish Pasha. Me rivendosjen e administratës osmane, u burgosën shumica e anëtarëve të degës së Lidhjes në Prizren. Në prill të vitit 1881, Dervish Pasha e burgosi dhe e internoi Sh. Spahiun me familje e tij në vilajetin e Adanës, në qytetin Nibs në Anadoll, ku u dënua me vdekje dhe u ekzekutua në qershor të vitit 1881. (Luan Tetaj)

SPAHIU Xhavit (1931-2010). Trajner, punëtor sportiv. Lindi në Krumë të Hasit, me prindër nga Gjakova. Shkollën fillore e nisi në Kukës dhe e përfundoi në Prizren, ku kreu dhe gjimnazin. Gjatë kësaj kohe u mor me sport. Xh. Spahiut dhe kolegëve të tij, Hajdar

Jakupit, Hajrullah Morinës, Masar Begollit, Ferdinand Shkelëzit, Xhemil Dodës, Arsimit Fehmiut e të tjerëve, u takon merita për zhvillimin e sportit në Kosovë. Me ardhjen e tij në Normalen e Prishtinës, në shtator të vitit 1953, fillon edhe veprimtaria e tij sportive, pikërisht në sportin e hendbollit. Po atë vit vijon një seminar në Beograd. Nga ky seminar ai solli në Prishtinë gjashtë topa të hendbollit. Pas dy muajsh u hartuan edhe propozicionet e garave, përmasat e fushës, rregullat e lojës, që janë të ngjashme me të sotmet. Me këtë histori lidhet pikërisht KH “Normalisti”, trajner i të cilit ishte Xh. Spahiu. Ai, së bashku me Drita Dobroshin, drejtorin Kemal Deva dhe Halil Dobroshin themeluan klubin e parë me emrin “Normalisti”. Skuadra ishte kampione e Kosovës gjashtë herë me radhë. Xh. Spahiu ishte edhe skitar i dalluar dhe ndër të parët në zhvillimin e kësaj dege sportive. Ushtri shumë funksione në asociacionet sportive të Kosovës. (Xhavit Kajtazi)

SPANËT. Familje bujare arbërore. Sipas modës humaniste, pjesëtarë të familjes Spani përpiqeshin të tregonin se kishin prejardhje nga Spanja ose nga ndonjë qendër e Bizantit. Ndërsa arkivat e Raguzës, sidomos regjistrat gjenealogjike të familjeve ofrojnë njoftime të hollësishme për këtë familje. Ata i gjejmë të jenë nga Shkodra, Lezha, ose përgjithësisht nga Arbëria. Pjesëtarët e parë të familjes Spani i ndeshim në Raguzë (1322), por edhe në qytete të tjera, si: Drisht, Lezhë, Durrës, Korçullë, Venedik, Novobërdë etj. Me rastin e rrethimit të Novobërdës nga osmanët (1454/55), është shquar vojvoda e qytetit, Pjetër Spani. Pjesëtarë të tjerë të kësaj familjeje u shquan në luftëra të Skënderbeut. Kishte të tillë, të cilët qenë angazhuar edhe në rrjedhat e zhvillimeve të historisë venedikase, bizantine dhe osmane. Spanët e Raguzës gjatë shek. XIV-XV kryen punë të rëndësishme shoqërore dhe intelektuale. Shërbyen edhe si famulltarë, siç ishte Pjetër Spani, njëri ndër famulltarët më të njohur të Raguzës. Nga më të shquarit e kësaj familjeje ishte mjeku Gjergj Spani, internist, kirurg që shërbeu si mjek kryesor në Kotorr, Raguzë, Paris dhe Padovë. Gjergj Spanin e gjejmë edhe në shërbim të kryezotëve të Bosnjës dhe të Zetës. Një shekull më vonë (XVI) në Raguzë veproi edhe një mjek i njohur i familjes Spani, i quajtur Gjergj Spani

i Arbërisë (*Georgius Spanus de Albania*). Pasi arriti moshën madhore, në vitin 1560 Senati Raguzan i dha bursë për të studiuar mjekësinë në Paris. Me të kryer studimet, Gjergj Spani i shek. XVI shkroi veprën “Si duhen mjekuar ata që lindën në trevën e Raguzës”, e cila u zhdruk me tërmetin e madh të vitit 1667, që rrënoi gati tërësisht Raguzën. (Jahja Drançolli)

SPITALET E UÇK-SË. Me nismën e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), mjekësia e luftës u krijua në fillim të vitit 1995, si departament i shëndetësisë i



NJË SPITAL I UÇK-SË

UÇK-së. Fillimi i luftës çlirimtare në Kosovë solli si nevojë organizimin dhe mbrojtjen shëndetësore, përkatësisht shërbimet e sanitetit në kushtet dhe rrethanat e luftës. Shërbimet e sanitetit fillimisht krijohen nga vullnetarët, me një çantë të ndihmës së parë, të pajisur me gjërat elementare për të plagosurit. Krahas shtrirjes dhe zgjerimit të zonave të luftës, shtohet nevoja e përkujdesjes shëndetësore të një niveli më të lartë, atij dytësor dhe tretësor (jashtë Kosovës). Në këtë kuadër u jetësua edhe shërbimi i sanitetit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ambulanca e parë ushtarake u hap në fshatin Ticë më 28 shkuan 1998 dhe më vonë në Likoc, Gradicë, Gajrak, Pagarushë, Bërshancë, Divjakë, Irzniq, Krushec, Kaçanoll, Potok, Llapashticë, Mollopolc etj. Më 27 prill të po atij viti në Likoc të Zonës Operative të Drenicës u hap spitali i parë ushtarak i Kosovës në zonat e luftës. Më pas spitale ushtarake u organizuan edhe në Zonën e Dukagjinit, të Pashtrikut, të Llapit, të Shalës dhe të Nerodimes. Përveç shërbimit të sanitetit dhe spitaleve ushtarake, mjekësia gjatë luftës së UÇK-së u organizua

edhe në ambulanca dhe poliklinika për shërbime civile.

Mjekësia e luftës u organizua në nivelin e parë (dhënie e ndihmës së parë mjekësore në vendin e ngjarjes, në vijën e parë të luftës). Në nivelin e dytë jepej ndihma në spitalet e improvizuara ushtarake, ku bëhej ekzaminimi, trajtimi kirurgjikal dhe kontrolli mjekësor. Niveli i tretë kishte të bënte me evakuimet në spitalet pritëse fushore, në vijën kufitare me Shqipërinë, prej nga bëhej evakuimi për në spitalet e Tiranës. Në raste të veçanta të plagosurit dërgoheshin për mjekim dhe rehabilitim në spitalet e shteteve të tjera. Sistemi i furnizimit me mjete dhe ilaçe bëhej nga dy drejtime, nga UÇK-ja dhe nga qendra e emergjencës te popullata civile si dhe nga ndihma shëndetësore që jepnin institucionet shëndetësore të Republikës së Shqipërisë. Gjatë luftës stafi mjekësor në krye me Fakultetin e Mjekësisë u vendos në shërbim të luftës. Duke dhënë ndihmë mjekësore për luftëtarët dhe popullsinë civile, gjatë luftës u vranë apo u zhdukën 19 mjekë, dy stomatologë, 1 farmacist, 6 studentë të Fakultetit të Mjekësisë dhe dhjetëra punëtorë shëndetësorë humanitarë. (Fadil Beka)

SPITALET RAJONALE TË KOSOVËS.

Mbrojtja spitalore në Kosovë jepet në 5 qendra mjekësore (spitalet e përgjithshme), të cilat ofrojnë mbrojtje shëndetësore dytësore. Mbrojtje shëndetësore dytësore dhe tretësore ofron edhe Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK).



SPITALI I PRIZRENIT

Spitalet e përgjithshme në Kosovë janë: *Spitali Rajonal i Prizrenit*, i themeluar në vitin 1912, ofron mbrojtjen shëndetësore të 6 komunave (Prizren, Therandë, Rahovec,

Malishevë, Dragash dhe Mamushë). Ka 13 reparte me 521 shtretër. Në këtë qendër punojnë 140 mjekë të profileve të ndryshme dhe 235 infermierë me shkollim të lartë dhe të mesëm.

Spitali Rajonal i Pejës, i themeluar në vitin 1924, ofron mbrojtjen shëndetësore të 4 komunave (Pejë, Klinë, Deçan dhe Istog). Spitali i Pejës ka 15 reparte me 405 shtretër. Në këtë qendër punojnë 89 mjekë të profileve të ndryshme dhe 159 infermierë me shkollim të lartë dhe të mesëm.

Spitali rajonal i Gjilanit, i themeluar në vitin 1954, ofron mbrojtjen shëndetësore të 4 komunave (Gjilan, Kamenicë, Viti dhe Novobërdë). Spitali i Gjilanit ka 13 reparte me 380 shtretër. Në këtë qendër punojnë 119 mjekë të profileve të ndryshme dhe 194 infermierë me shkollim të mesëm dhe të lartë.

Spitali Rajonal i Gjakovës, i themeluar në vitin 1956, ofron mbrojtjen shëndetësore vetëm për komunën e Gjakovës. Spitali i Gjakovës ka 15 reparte me 426 shtretër. Në këtë qendër spitalore punojnë 57 mjekë të profileve të ndryshme dhe 9 mjekë të përgjithshëm dhe 225 infermierë me shkollim të lartë dhe të mesëm.



SPITALI I GJAKOVËS

Spitali Rajonal i Mitrovicës, është themeluar në vitin 1936 dhe deri në vitin 2000 ka ofruar mbrojtjen shëndetësore të 5 komunave (Mitrovicë, Vushtrri, Skënderaj, Zubin Potok dhe Leposaviq). Spitali i Mitrovicës ka 15 reparte me 608 shtretër. Kjo qendër ndodhet në veriun e Mitrovicës dhe pas luftës është uzurpuar nga serbët lokalë. Popullata shqiptare nuk ka qasje në këtë spital dhe në të nuk ka mjekë shqiptarë. Sot ofron mbrojtje shëndetësore për komunat serbe të veriut dhe enklavat serbe.

Spitali i ri i Mitrovicës së Jugut, u themelua në vitin 2010 dhe ka 10 reparte më 153 shtretër. Në të punojnë 29 mjekë dhe 114 infermierë me shkollim të mesëm dhe të lartë.

Spitali i Ferizajt, i themeluar në dhjetor të vitit 1999, ofron mbrojtje të kufizuar dytësore për komunën e Ferizajt, Kaçanikut, Shtërpcës dhe Shtimes. Spitali ka 64 shtretër të ndarë për qëllime pediatrike, të rasteve me sëmundje infektive, të kirurgjisë urgjente dhe lindëtores rajonale. Në këtë spital punojnë 21 mjekë dhe 55 infermierë.

Spitali i Vushtrrisë, u themelua në vitin 2000, si donacion nga Emiratet e Bashkuara Arabe, i pajisur me teknologji bashkëkohore. Ka 6 reparte me 72 shtretër. Në këtë spital punojnë 18 mjekë dhe 47 infermierë, mami dhe laborantë.

Spitali i Mushkërive në Pejë, me traditë 65-vjeçare, i ndërtuar për trajtim e pacientëve me TBC nga e gjithë Kosova. U rifunksionalizua më 2012, pas një pauze mbi dhjetëvjeçare. Ka 120 shtretër dhe në të punojnë 10 mjekë dhe 30 infermierë. (Isuf Dedushaj)

SPORTI NË KOSOVË. Deri në shekullin XXI, sporti në Kosovë u zhvillua në rrethana të veçanta, i varur nga kushtet historike dhe politike nëpër të cilat kaloi vetë Kosova. Historia



e gjatë e sportit në Kosovë zë fill qysh në shekujt gjashtë dhe të pestë para erës së re, kur shfaqen dëshmitë arkeologjike për këtë veprimtari. Është shtatorja “Vrapuesja e Prizrenit”, e derdhur në bronz, e cila jep pamjen e vajzës në pozitë vrapimi, e veshur me një kiton të gjatë e të hollë, pa mëngë, në pozitë vrapimi, me një trup të bëshëm dhe muskuloz. Vetë pozita e vrapimit, hapi elegant dhe ngadhënjimtar, shikimi bredhës dhe shqetësues, që duket sikur ndjek garistet rivale, janë tipare të atletes në një garë vrapimi. Zanafilla nga lashtësia e

këtyre gjetjeve arkeologjike vërteton pohimet se dardanët kanë qenë njohës dhe njëkohësisht edhe adhurues të lojërave sportive që organizoheshin në antikitet. Reliktet e këtyre lojërave të shqiptarët e Kosovës shfaqen edhe gjatë dasmave dhe festave të ndryshme, qoftë në garat e vrapimeve të meshkujve për flamur, vrapimet me kuaj, mundje, hedhje të gurapeshit, kërcim së largu etj. Fillet e sportit në Kosovë gjatë kohës së sundimit osman u shfaqën përmes lojërave popullore, duke përcjellë traditën e hershme të shqiptarëve. Ndërkaq, në dhjetëvjetëshin e parë të shekullit XX në Kosovë u themeluan të ashtuquajturat shoqëritë sokole, që kishin në program edhe veprimtaritë sportive. Shoqëria e parë sokole u shfaq në Prizren në vitin 1909. Me ardhjen e austro-hungarezëve në Kosovë (1914-1918) u krijuan klubet e para sportive. Pas Luftës së Dytë Botërore sporti në Kosovë u zhvillua shkallë-shkallë, përfshirë këtu themelimin e shumë klubeve dhe të federatave të sportit. U ndërtuan një varg objektsh sportive, që ndikuan në arritjen e rezultateve më të mira. Në këtë periudhë suksesin më të madh Kosova e arriti në boks (KB “Prishtina”), në futboll (KF “Prishtina”, KF “Trepça”, KF “Liria”, KF “Vëllaznimi”), në hendboll (KH “Borci”, KH “Trepça”), në basketboll (KB “Universiteti”, femrat) etj. Ndërkaq, sportin e Kosovës në dhjetëvjeçarin e fundit të shekullit XX e karakterizoi dhuna e përhershme e policisë serbe ndaj shqiptarëve, e cila e shkatërroi tërësisht gjithë atë që ishte krijuar me punën dhe mundin e tyre. Mirëpo, punëtorët dhe sportistët iu kundërpërgjigjën këtij veprimi me organizimin e sportit të pavarur të Kosovës, që u bë në vitin 1991. Ky model i veprimit të sportit në Kosovë në rrethana lufte, që nuk pushoi për nëntë vjet, në analet e sportit është i rrallë, madje i pashembullt në historinë e sportit modern në botë. Pas luftës së vitit 1999 sportit kosovar iu krijuan mundësi të reja dhe u hap perspektiva e ndërkombëtarizimit të tij. (Xhavit Kajtazi)

SRECKA. Fshat në komunën e Prizrenit, 12 km në juglindje të tij. Shtrihet në rajonin e Zhupës së Sreckës, në luginën e Lumëbardhit të Prizrenit, rrëzë maleve të Sharrit, në lartësinë mbidetare 700 m. Sipërfaqja e zonës kadastrale të Sreckës është 12.3 km². Është vendbanim i ndarë në lagje të tipit të dendur. Si vendbanim

me emrin Isireçka është regjistruar në defterin e Sanxhakut të Prizrenit të vitit 1530 me 68 shtëpi. Një numër i konsiderueshëm i banorëve të fshatit emigroi brenda dhe jashtë Kosovës. Kjo është reflektuar në zvogëlim e numrit të popullsisë dhe regresin e përgjithshëm demografik. Sipas të dhënave të regjistrimit të fundit (2011) Srecka kishte 69 banorë, ndërsa në vitin 1948 ajo kishte pasur 1,067 banorë. Derisa më herët Srecka ishte qendër e Zhupës, intensifikimi i emigrimit, i cili ka marrë përmasa të shpopullimit, është manifestuar në zbehjen e rëndësisë së dikurshme funksionale. Popullsia kryesisht merret me veprimtari shërbyese-hoteliere. Nga objektet e standardit shoqëror ka shkollën fillore, shtëpinë e kulturës, njësi tregtare etj. (Hasim Kryeziu)

SREDSKA. Trevë në pjesën jugore të Kosovës, ndodhet në Malet e Sharrit dhe shtrihet përgjatë rrjedhës së Lumëbardhit të Prizrenit, në mes të malit Oshlak në veri dhe Malit Sharr në jug. Relievin e përbëjnë malet e larta me forma akullnajore dhe të denudimit. Në këtë zonë, Lumëbardhi i Prizrenit ka prerë kanionin e tij mjaft pitoresk. Nëpër Sredskë kalon rruga që lidh Prizrenin me qafën e Prevallës, Brezovicën, Siriniqin dhe del në Fushën e Kosovës. Peizazhin e dominojnë pyjet dhe kullosat. Popullsia merret me blegtori dhe pylltari. Sredska ka një gjatësi prej 17.5 km dhe gjerësi 12.5 km. Jetojnë rreth dhjetë mijë banorë, pjesa më e madhe boshnjakë (80%), kurse pjesa tjetër shqiptarë (20%). Sredska ka gjithsej 13 vendbanime. (Selim Qevani)

SREJOVIQ (Srejojić) Dragoslav (1931-1996). Arkeolog serb, akademik, profesor universitar. Udhëhoqi shumë ekspedita arkeologjike të lokaliteteve parahistorike e antike në Serbi e Mal të Zi, pos Lepenski Viri mezolitik dhe Gamzigradi antik. Shkroi një sërë artikujsh shkencorë, dhjetëra katalogë e guida dhe 20 monografi, në mesin e tyre: "Vorbulla e Lepenit" (1969), "Fjalor i mitologjisë greke dhe romake" (1979), "Leksikon i religjioneve dhe miteve të Europës së vjetër" (1992) etj. Në Kosovë hulumtoi vendbanimin shumëstresor dhe nekropolin parahistorik në Karagaç te Zveçani, nekropolin parahistorik të Bërnicsës së Poshtme dhe tumën tek "Arat e Çerkezit", tek Ulpiana (shek. II-III). (Haxhi Mehmetaj)

SËRZENTIQ Kërsta (Krsta Srzentić) (1926-). Aktor. Lindi në Mitrovicë, ku mbaroi shkollën fillore dhe të mesme. Në Tetarin Popullor Krahinor u inkuadrua nga viti 1959, ku realizoi një sërë rolesh, shumë prej tyre role kryesore ose dytësore. Prej tyre mund të veçohen rolet në shfaqjet: "Strofulla e ujkut", "Zonja ministreshë", "Familja e pikëlluar", "Nuk martohem me parë", "Zona Zamfirit" etj. Për punën e tij në teatër ka marrë çmime dhe mirënjohje. (Fadil Hysaj)

STACIONET BENEFICIARE. Institucione me karakter ushtarak të periudhës romake. Kishin për detyrë ruajtjen e rendit dhe të sigurisë së qytetarëve romakë, por lidheshin ngushtë edhe me zhvillimet e përgjithshme të ekonomisë në provincat romake, si dhe shqyrtonin kundërvajtjet e vogla. Mendohet se funksionin e njëjtë e ushtronin edhe në distriktet minerale dhe, në raste të veçanta, kryenin dhe funksionin e shërbyesve të inteligjencës në Perandorinë Romake. Beneficiarë ishin legjionarët me grada të larta. Në provincën e Mezisë së Epërme këta ishin në kuadër të Legjionit VII Klaudia dhe Legjionit IV Flavia. Deri nga fundi i shek. II është dëshmuar numër i vogël i stacioneve beneficiare. Dëshmitë më të hershme janë hasur në një nekropol të qytetit antik Sirmium (Mitrovica e Sremit), ku janë zbuluar 84 altarë të dedikuar nga konsularët beneficiarë të Panonisë së Poshtme (shek. I-II). Në Kosovë janë dëshmuar katër stacione beneficiare, në Dobruzhde të Prizreni, Mitrovica, Ulpiana dhe Kaçaniku. Këto gjendeshin afër traseve të dy rrugëve kryesore: Lezhë-Nish (Lissus-Naissus) dhe trasesë që lidhte perëndimin e Ballkanit me Shkupin e Maqedoninë. Beneficiarët janë dëshmuar në Dardani deri në shek. III, ndërsa në provincat e tjera romake deri në shekullin IV. (Arianit Buçinca)

STACIONI RRUGOR I POSLISHTËS. Stacion rrugor në aksin rrugor Lissus-Naissus. Ndodhet rreth 5 km në jug të Prizrenit dhe u zbulua gjatë ndërtimit të segmentit rrugor të autostradës Vermicë-Prishtinë, në anën e djathtë të saj (2010). Gjatë gërmimeve me karakter shpëtimi u evidentua objekti arkitektonik me disa anekse, njëri ambient stalle kuajsh dhe mbetjet e një therme të periudhës romake. Mbështetur në materialin e pakët arkeologjik, lokaliteti i takon shek. III-IV. Sipas gjetjeve arkeologjike, pozicionit të

vendbanimit, distancës që kishte me Therandën dhe Gabuleon, mund të supozohet se lokaliteti paraqet mbetjet e një stacioni rrugor të tipit mutationes. (Shafi Gashi)

STADIUMET E FUTBOLLIT. Në Kosovë ekzistojnë mbi 60 stadione të futbollit, që frekuentohen nga futbollistët, disa prej të cilëve nuk i plotësojnë as kushtet elementare.



STADIUMI I PRISHTINËS

Shumica prej stadioneve të përdorshme kanë mungesë infrastrukture për t'i plotësuar kriteret ndërkombëtare. Stadiumi që deri diku i plotëson normat europiane është ai "Adem Jashari" në Mitrovicë. U ndërtua në vitin 1978, ndërsa më 2014 u rinovua tërësisht. Stadiumi i "Trepçës" është po ashtu më i madhi për nga kapaciteti, me 18,200 ulëse. Pastaj vjen ai i "Prishtinës" me 16,200 ulëse, i ndërtuar në vitin 1951. Të ndërtuar që herët janë edhe stadiumi i "Flamurtarit" në Prishtinë, ai i "Besës" në Pejë, me kapacitet prej 8,200 ulëseve, pastaj stadiumi i "Lirisë" në Prizren "Përparim Thaçi" etj. Më 2012 Ministria e Sportit e Kosovës mori vendim për rinovimin e 11 stadioneve. Në të njëjtin vit Ministria e Sportit nisi ndërtimin e gjashtë stadioneve të tjera ndihmëse, me një donacion të Komisionit Europian. (Leutrim Mustafa)

SHTATMYLER (Stadmüller) Georg (1909-1985). Historian dhe albanolog. Lindi në Büstadt të Hesenit (Gjermani). Studioi historinë gjermane, filologjinë klasike e orientale dhe historinë në Universitetin e Friburgut (1927-1931). Udhëheqës i departamentit të historisë në Universitetin e Munihut dhe specialist i historisë së Europës Lindore. U mor në veçanti me historinë e shqiptarëve, studioi prejardhjen e shqiptarëve dhe nxori tezën se prejardhja e



GEORG
SHTATMYLER

shqiptare buronte nga rajoni i Matit. Teza e re e tij lidhet me grupet kripto-religjioze të hapësirave të Ballkanit, në të cilat popullata u konvertua në fenë islame. Në mesin e veprave të tij janë: "Studime mbi parahistorinë shqiptare" (1942), "Islamizimi te shqiptarët" (1950), "Besimet e vjetra pagane dhe krishterimi në Shqipëri", "Këshilli kombëtar shqiptar nga viti 1703" (1956) etj. (Edi Shukriu)

STAJFAJ Ardit (1980-). Kitarist dhe këngëtar i muzikës së lehtë. Lindi në Prishtinë. Shkollën e Ulët të Muzikës e kreu në Prishtinë, ndërsa Shkollën e Mesme të Muzikës në Tetovë. Më pas ndoqi studimet në Fakultetin e Muzikës në Prishtinë dhe u diplomua në drejtimin teorik-pedagogjik. Nga viti 1995 ka qenë aktiv në koncerte, festivale e spektakle muzikore të muzikës së lehtë. Deri më tani është fitues i të gjitha çmimeve nga zhanri që e ndjek pa ndërprerje. Gjatë afro dy dekadave ishte dhe vazhdon të jetë si udhërrëfyes për shumë artistë të rinj. Jeton e vepron në Gostivar. (Arnisa Rexhepi)

STANDARDET KOSOVARE (SK). Dokument i hartuar, i adoptuar, i miratuar dhe i publikuar nga Agjencia Kosovare e Standardizimit (AKS) në përputhje me kërkesat e Ligjit për standardizimin nr. 03/L-144, dt. 30.9.2009. Standardet janë specifikime teknike, të cilat hartohen ose adoptohen me konsensus në komitete teknike me pjesëmarrjen e të interesuarve dhe miratohen nga një organ i njohur standardizimi. Standardet në vetvete përmbajnë karakteristikat e kërkuara për një produkt, siç janë niveli i cilësisë, vetitë, siguria, përmasat, duke përfshirë edhe terminologjinë e simbolet, metodat dhe procedurat e provave e të analizave, paketimin dhe etiketimin. Standardet i bëjnë projektimet, produktet dhe shërbimet më efektive, më të sigurta dhe më transparente. Ato i mbrojnë përdoruesit dhe konsumatorët dhe i bëjnë më të thjeshta shumë aspekte të jetës së tyre. Standardet janë dokumente vullnetare. Ato bëhen të detyrueshme për zbatim, kur kjo gjë kërkohet nga aktet ligjore ose nënligjore, ose në kushtet e një kontrate midis

shitësit e blerësit. Në vendin tonë kryesisht adoptohen dhe përdoren standardet ndërkombëtare “ISO” dhe standardet europiane “EN”. Gjatë adoptimit të tyre si standarde kosovare mbahet parasysh niveli teknologjik i arritur në vend dhe faktorë të tjerë. SK-të kanë të njëjtën vlerë për të gjithë personat fizikë dhe juridikë, vendës e të huaj, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Kosovë. Standardet kontribuojnë ndjeshëm në rritjen ekonomike të vendit. Adoptimi i sa më shumë standardeve ndërkombëtare ISO dhe europiane EN ndikon në rritjen e cilësisë e të sigurisë së produkteve dhe njëkohësisht mënjanon barrierat teknike në tregti. AKS-ja është institucion në varësi të Ministrisë së Tregtisë dhe të Industrisë. (Nebi Caka).

STANDARDI I JETESËS. Niveli i posedimit të të mirave materiale për të përmbushur nevojat e përditshme të jetesës te qytetarët e një vendi, të një rajoni apo të një shtrese shoqërore. Përfshin kategoritë si të ardhurat në dispozicion, punësimin, shkallën e varfërisë, gjatësinë e orarit të punës, inflacionin, qasjen në edukim dhe shëndetësi, qasjen në infrastrukturën dhe shërbimet publike, pushimet vjetore e javore të të punësuarve, cilësia e fondit të banimi dhe kushtet e banimit të të punësuarve, si dhe mënyrën e shfrytëzimit të kohës së lirë. E tërë kjo shprehet në vëllimin dhe strukturën e konsumit. Kohëve të fundit përfshihet në standardin e jetesës edhe cilësia e mjedisit (ujit, ajrit dhe tokës, në aspektin e shkallës së ndotjes). Pra, standardi i jetesës është i lidhur me cilësinë e jetesës së qytetarëve të një vendi. Banka Botërore ka futur në qarkullim një model ankete për matjen e standardit të jetesës, nëpërmjet së cilës gjenerohen të dhëna që bazohen në anketat e familjeve. Prej sa u tha më lart është vështirë të ndërtohet një tregues me të cilin do të shprehej niveli i standardit të jetesës në një vend. Megjithatë, produkti i brendshëm bruto dhe të ardhurat kombëtare për një banor, indeksi i zhvillimit njerëzor, lëvizja e kostos së jetesës dhe konsumit japin indikacione lidhur me standardin e jetesës. Kosova ballafaqohet me probleme lidhur me ngritjen e standardit të jetesës, deri në nivelet sa ato të marrin më tepër tiparet europiane për shkak të mundësive të kufizuara për punësim, varfërisë së lartë dhe zhvillimit të pamjaftueshëm të infrastrukturës dhe shërbimeve publike. (Muhamet Mustafa)

STANDARDIZIMI I ARSIMIT. Proces i përafrimit dhe i harmonizimit të standardeve të arsimit në Kosovë me standardet e arsimit në Bashkimin Europian. Ka të bëjë me miratimin e normave (standardeve) europiane dhe me arritjen e tyre në të gjitha dimensionet e arsimit, duke përfshirë sistemin e arsimit, shkollët e shkollimit, legjislacionin shkollor, arsimin e detyrueshëm, nivelet e kualifikimit profesional, kualifikimin e mësimdhënësve, kurikulën, mbështetur në kompetenca, altertektstin, licencimin e mësimdhënësve, arsimin gjithëpërfshirës, akreditimin e arsimit të lartë etj., e gjithë kjo me qëllim të ngritjes së cilësisë dhe të efikasitetit të mësimin dhe të sistemit të arsimit, të krahasueshme me standardet europiane. Në krye të këtij procesi gjendet Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë e Kosovës. (Naser Zabeli)

STANEKI Ali-Syla (1910-1947). Veprimtar i lëvizjes nacionaliste. Lindi në Preshevë. Shkollën fillore e kreu në Preshevë. Emigroi në Shqipëri, në Elbasan. Pas kthimit nga Shqipëria, burgoset nga organet e Mbretërisë Jugosllave. Me të filluar Lufta e Dytë Botërore, arratiset nga burgu dhe kthehet në vendlindje. Merr pjesë na formacione ushtarake të quajtura “Kontraçeta”, të formuara nga pushtuesi bullgar. Pas konfliktit me drejtuesin malazias, Jagosh Janiqin, vazhdon aktivitetin ushtarak, duke formuar “kontraçetën” me shqiptarë. Bashkëpunoi dhe udhëhoqi lëvizjen nacionaliste në Karadakun e Kumanovës. Në vitin 1943, nga kuvendi i kësaj lëvizjeje u zgjodh udhëheqës i shtabit në Stanec. Mori pjesë në tubimin e Mateçit (Kumanovë) më 9 shtator 1944, ku u zgjodh anëtar i shtabit ushtarak. Në vitin 1947 likuidohet nga organet e OZN-ës në rrethin e Shkupit. (Ilir Zylfiu).

STANEKI Limon (1916-1991). Veprimtar i lëvizjes nacionaliste. Lindi në Preshevë. Studio në Fakultetin Juridik në Beograd. Ishte sekretar i Komitetit Qarkor të Lidhjes së Dytë të Prizrenit për Nënëprefekturën e Gjilanit (1943-1944). Gazetar në gazetën “Lidhja e Dytë e Prizrenit”. Raportonte për zhvillimet në frontin e Gjilanit. Pas okupimit bullgar u zgjodh nënprefekt i Preshevës. Ishte sekretar i Idriz Hajrullahut, gjykatës dhe kryeshef i Rrethit të Gjilanit. Pas luftës qëndroi në malet e Karadakut, ku më 1947 dorëzohet. Gjykata e Qarkut në Gjilan

i shqipton dënimin me vdekje, pushkatim (1947). Në gusht të vitit 1947, Presidiumi i Republikës Popullore Federative të Jugosllavisë vendimin e gjykatës e shndërron në 20 vjet burgim të rëndë. Vdiq në Preshevë. (Iilir Zylfiu)

STANISHIQ Petar (Stanišić) (1933-). Ekonomist, profesor universiteti. Lindi në Nikshiq, në Mal të Zi. Fakultetin Juridik e mbaroi në Shkup, studimet pasuniversitare në Beograd. Shumë vjet punoi në Fakultetin Juridik dhe Ekonomik të Universitetit të Prishtinës, pastaj ishte dekan në këto fakultete, ndërsa kreu edhe funksione me rëndësi në institucionet e Kosovës dhe të ish-Jugosllavisë në periudhën e autonomisë: anëtar i Komisionit Kushtetues të Kuvendit Krahinor i KSA të Kosovës, anëtar i Këshillit Ekonomik Federativ në kuadër të Këshillit Ekzekutiv Federativ, kryetar i Gjykatës Ekonomike të Vetëqeverisjes, zëvendës-gubernator i Bankës Popullore të KSA të Kosovës etj. Gjithashtu bënte pjesë në këshillat redaktuese dhe redaksitë e disa revistave profesionale të fushës së ekonomisë, që botoheshin në atë periudhë. Gjatë punës në Universitet botoi edhe një numër punimesh shkencore dhe profesionale dhe mori pjesë në shumë konferenca shkencore. (Selman Selmanaj)

STANTËRGU. Vendbanim xehetar-industrial i tipit të dendur në luginën e lumit Trepça, në anën e djathtë të lumit Sitnica, 7 km në verilindje të Mitrovicës. Shtrihet në lartësi mbidetare 760-820 m, me zonën kadastrale prej 451 ha. Gjenezja dhe zhvillimi i këtij vendbanimi është e lidhur kryekëput me aktivitetin xehetar të “Trepçës”. Nga koha e mesjetës e deri në ditët tona njihet si lokalitet me xeheroren e plumbit, zinkut, arit dhe argjendit. Në vitin 1610 njihej me emrin Trepça, që kishte 500 shtëpi. Kulmin e zhvillimit e arrin në shekullin XV, atëherë kur sasët dhe tregtarët e Dubrovnikut ndërjuan koloninë e tyre të njohur. Në fillim të shekullit XX xeherorja sërish përjetoj një zhvillim të hovshëm, kur në vitin 1924 bëhet pronë e kompanisë angleze “Trepça Minels Limited” me qendër në Londër. Në vitin 1981 Stantërgu kishte 1,490 banorë, ndërsa sipas regjistrimit të fundit (2011) në të jetojnë 1,042 banorë. Përmban karakteristika të rëndësishme urbane: godina banimi, objekte industriale të Trepçës, motelin, basenin olimpik etj. Ka

shkollë 9-vjeçare, muzeun me lloje unike të mineraleve dhe të kristaleve, bibliotekën, shoqëri kulturore-artistike, shtëpi shëndeti dhe shumë objekte të tjera me rëndësi shoqërore. (Ibrahim Ramadani)

STAROVA Luan (1941-). Romancier, poet, eseist. Lindi në Pogradec. Shkollën fillore, gjimnazin dhe studimet për gjuhë e letërsi frënge i kreu në Shkup. U doktorua në Zagreb.



LUAN STAROVA

Në fillim punoi si gazetar në një gazetë të rinjsh në Shkup, më pas, deri në pensionim, ishte profesor i letërsisë frënge në Universitetin e Shkupit. Ishte ambasador i ish-Jugosllavisë në Tunizi. Pas prishjes së Jugosllavisë, qe ambasador i Maqedonisë në Paris. Veprat: “Kufijtë e pranverës” (1971), “Barrikatat e kohës” (1976), “Afrime” (1982), “Njerëz dhe ura” (1984), “Çelësi i Ballkanit” (1995), “Librat e babait” (1992), “Koha e dhive” (1993), Muzeu ateist” (1996) “Rruga e ngjalave” (1999), “Kthimi i Faik Konicës” (1999), “Një miqësi evropiane: F. Konica-G.Apoliner” (2001), “Kështjella prej hiri” (2002), “Erveheja” (2005), “Në kërkim të Elen Leibovic” (2008), “Dashuria e gjeneralit” (2008), “Ambasadat” (2009), “Ambasada të reja” (2009), “Ballkan babilonët” (2014). Me shkrime publicistike dhe eseistike Luan Starova filloi që nga fillimi i viteve shtatëdhjetë të shekullit të kaluar. Më vonë, nga fillimi i viteve nëntëdhjetë, Luan Starova për njëzet e pesë vjet po kompletton një sagë romanore të veçantë, fare karakteristike në letërsinë shqipe. Kjo sagë, që për temë kryesore ka fatin e një familjeje shqiptare, përkatësisht të familjes së vet, që shpërngulet nga vendlindja, Pogradeci, dhe vendoset në Maqedoni. Harku kohor brenda së cilës zhvillohet kjo sagë, që deri më sot ka katërmëdhjetë romane të botuar, zhvillohet në një hapësirë, në fillim ballkanike, e më pas përtej kufijve të Ballkanit. Boshti i historisë së rrëfyer në këtë cikël narrativ është rruga, fati i një familjeje shqiptare që emigron nga vendlindja drejt hapësirave më frymëmarrëse dhe gjakimi i saj dramatik që sa për të lëshuar rrënjë në truall të ri, e sa për t’i mbajtur gjallë ato të origjinës. Kërkimi i një baraspeshe mes këtyre dy ngasjeve të brendshme, përkatësisht

dy identiteteve prore të zgjuara dhe në çaste tunduese e agresive, të dhembshme, është tharimi kryesor që e përshkon rrëfimin-autorrrëfimin e birit të familjes. Është njëri nga shkrimtarët shqiptarë më të përkthyer në gjuhë të huaja, fitues i shumë çmimeve letrare ndërkombëtare dhe vendore. (Ali Aliu)

STATOVCI Ardita (1982-). Pianiste. Lindi në Prishtinë. Mësimet e para për piano i filloi në vendlindje. Në moshën 15-vjeçare u pranua në Mozarteum University në Salzburg, Austri.



ARDITA STATOVCI

Kreu studimet pasuniversitare në vitin 2007 në klasën e prof. Christoph Lieske. A. Statovci studio me pedagogun e njour Menahem Pressler në "Indiana University" në Bloomington (2009). Ajo punoi edhe me pedagogët Boris Petrushansky e Franco Scala në Itali. Pianiste me aktivitet të ngjeshur interpretues. Performoi në mbarë Europën, SHBA dhe në Azi. Koncerton edhe me orkestra të njohura si: Mahler Chamber Orchestra, Mozart Orchestra (Bolonjë), Haydn Orchester (Bolzano), Wiener Sinfonietta, Kammerorchester (Bern) etj. Ka koncertuar edhe në Kosovë, duke u paraqitur me recitale, por edhe me Orkestrën e Filarmonisë së Kosovës. Për punën e saj dhe arritjet ka marrë shumë mirënjohje e çmime: çmimin "Bösendorfer" në garat Yehudi Menuhin Live Music Now në Salzburg, "Bösendorfer Prize" në Universitetin Mozarteum, në garat ndërkombëtare IBLA, në Itali etj. Është e nominuar si "Artistja e re Steinway" nga "Steinway & Sons". Jeton dhe vepron në Vjenë. (Rreze Kryeziu-Breznica)

STATOVCI Drita (1945-). Etnologe, hulumtuese shkencore, profesoreshë universitare. Lindi në Gjiilan, ku mbaroi shkollën fillore dhe të mesme. Kreu studimet universitare në degën



DRITA STATOVCI

e gjeografisë në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës (UP). Studimet pasuniversitare i kreu në Universitetin e Zagrebit dhe doktoratën e mbrojti më 1981 po në këtë universitet. Punoi në

Odën Ekonomike të Kosovës, ndërsa më vonë u angazhua në Institutin Kosovar për Planifikim Shoqëror dhe në Institutin e Historisë, si bashkëpunëtorë shkencore (1972-1977). Më pas merr drejtimin e Seksionit të Etnologjisë në Institutin Albanologjik të Prishtinës. Karrierën universitare e filloi si bashkëpunëtorë në departamentin e historisë të Fakulteti Filozofik të UP-së. Në vitin 2001 ishte iniciatore për themelimin e departamentit të etnologjisë në Fakultetin Filozofik të UP-së, të cilin e udhëhoqi deri në vitin 2012. Ka publikuar numër të madh të artikujve shkencorë dhe disa vepra monografike: "Zhvillimi historik i zejtarisë dhe rëndësia e saj bashkëkohore për strukturën ekonomiko-shoqërore të KSA të Kosovës", "Kërkime etnografike", "Etnologjia flet", "Veshjet shqiptare të Kosovës". Ishte aktive në periudhën 1989-1991 në lëvizjen për pajtimin e gjaqeve. Për dy mandate (2001-2007) ishte deputete e Kuvendit të Kosovës. (Nita Luci)

STATOVCI Ejup (1940-1999). Jurist, profesor universitar. Lindi në Prugoc të Prishtinës, shkollën normale e kreu në Prishtinë, diplomoi dhe magjistroi në Fakultetin Juridik të Univer-



EJUP STATOVCI

sitetit të Zagrebit, ndërsa doktoroi në Fakultetin Juridik të Universitetit të Lubjanës. Në vitin 1980 u zgjodh profesor i rregullt në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës (UP), ku ushtroi një sërë funksionesh drejtuese dhe akademike. Qëndroi disa herë për hulumtime shkencore jashtë vendit, si në Universitetin e Harvardit, të Oksfordit dhe të Kembrixhit. Në nëntor të vitit 1991 u zgjodh rektor i UP-së, duke dhënë kontribut të jashtëzakonshëm në organizimin e mësimit dhe institucionizimin e universitetit në kushtet e dëbimit të studentëve dhe profesorëve nga objektet e tyre, si dhe të dhunës së vazhdueshme policore mbi këtë institucion. Si rektor i UP-së ai u dënua me burg nga regjimi i atëhershëm serb, për shkak se kundërshtoi uzurpimin e pronës së UP-së për ndërtimin ilegal të Kishës Ortodokse në hapësirat e kampusit universitar. Më pas u arrestua gjatë protestave studentore të 1 tetorit 1997. Gjithashtu dha kontribut për

ndërkombëtarizimin e UP-së, duke nxitur bashkëpunimin me universitete prestigjioze në fushën e studimeve dhe të specializimit të kuadrit universitar. Në këtë kohë UP-ja u pranua në Konferencën Europiane të Rektorëve. Qëndroi në postin e rektorit deri në dhjetor të vitit 1997. E. Statovci zhvilloi një veprimtari të pasur shkencore, me shumë punime të botuara në revista të ndryshme dhe me disa monografi shkencore: “Marrëdhëniet pronësore-juridike në sendet e paluajtshme në KSA të Kosovës” (1977), “Mbrojtja e pronësisë” (1980), “Pronësia, origjina dhe zhvillimi” (1983), “E drejta e servituteve” (1985), “E drejta e pengut” (1988), “Të drejtat, liritë e njeriut dhe skllavërimi” (1999), dy prej të cilave të botuara edhe në gjuhën serbokroate. Për punën e tij shkencore dhe arsimore u dekorua me shumë çmime dhe mirënjohje. (Nerxhivane G. Dauti)

STATUSI JURIDIK I MARRËDHËNIEVE KOSOVË-BE. Deri në fund të vitit 2015, Kosova pati marrëdhënie kontraktuale me Bashkimin Europian (BE). Marrëdhëniet e rregullta, si me shtetet e tjera të Ballkanit Perëndimor nuk u vendosën, për shkak të mosnjohjes së Kosovës nga BE-ja si tërësi, si pasojë e kundërshtimit të 5 shteteve anëtare që nuk e njohën Republikën e Kosovës. Për pranimin e anëtarëve të rinj kërkohet miratim njëzëri (konsensual) nga Këshilli Europian. Si pasojë, për dallim nga shtetet e tjera, BE-ja nuk aplikoi për Kosovën marrëveshjet, procedurat dhe mekanizmat standardë, si me një shtet sovran. BE-ja nuk hapi në Prishtinë zyrën e delegacionit të KE-së (më herët), as ambasadën e BE-së në Prishtinë (aktualisht), por vetëm zyrën e saj ndërlidhëse. Pas pavarësimit, Republika e Kosovës hapi vetëm ambasadën e saj në Belgjikë, por jo edhe misionin e saj diplomatik në BE. Pas vitit 2013, BE-ja bëri dy lëvizje në raport me Kosovën: së pari, në dokumentet e saj zyrtare nuk e trajtoi më Kosovën si “pjesë e Serbisë”, por as nuk e njohu si shtet të pavarur, duke përdorur te emri i Kosovës referencën se BE-ja “nuk prejjudikon statusin e Kosovës” dhe, së dyti, më 27 tetor 2015, BE-ja nënshkroi Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit me Republikën e Kosovës. (Blerim Reka.)

STATUTET E QYTETEVE MESJETARE. Përmbledhje dispozitash ligjore, sipas të cilave banorët e qyteteve rregullonin organizimin e

tyre të brendshëm, duke respektuar shkallën e autonomisë, e cila ishte shprehur në mënyrë të qartë nga autoriteti suprem. Që në kohën e mesjetës së zhvilluar statutet u shfaqën në komunat autonome ose në komuna urbane në të gjithë Europën. Në traditën e statuteve perëndimore janë të rëndësishme statutet e *Westminsterit* (1275 dhe 1285), statuti *Gloucester* (1278) dhe statuti *Quia emptores* (1290), të lëshuar nga mbreti anglez Eduard I. Në hapësirat arbërore janë të njohur statutet e Buduas (shek. XIV), Danjës (1445), Drishtit (1397), Durrësit (1392), Shkodrës (1396), Tivarit (1330), Ulqinit (1330) etj. Lidhur më marrëdhëniet e afërta me këto hapësira janë të rëndësishme edhe statutet dalmate: Statuti i Korçullës (1214), i Kotorrit (1301, 1383, 1420), i Raguzës (1272), i Zarës (1305) etj. Statute të veçantë janë shkruar për qytetet minerare, sidomos për ato të Kosovës, që konsideroheshin koloni të fuqishme raguzane, korrarse etj. Ishte i njohur statuti i qytetit minerar të Novobërdës (1402/1403), të cilit më pastaj iu shtuan vetëm dispozitat shtesë në lidhje me qytetin e Novobërdës. Një tip tjetër i qyteteve autonome u zhvillua nën ndikimin e Bizantit, si Lipjani, Prizreni, Shkupi etj. Ndërsa qytete të tjera, si Peja, Prishtina dhe Vuçitërna konsideroheshin qytete autonome autoktone. (Jahja Drançolli)

STAVILECI Blerim (1949-). Gazetar. Lindi në Prishtinë, ku mbaroi shkollën fillore dhe të mesme. Fakultetin e Shkencave Politike e kreu në Universitetin e Lubjanës. Në vitin 1974 nisi punën në “Rilindje”. Fillimisht punoi gazetar, kurse nga viti 1977 ishte redaktor, kryesisht i faqeve dhe i rubrikave politike. Në vitin 1998 zgjidhet drejtor i gazetës “Rilindja”. Ndër vite ishte bashkëpunëtor i gazetave “Delo” e “Dnevnik” të Lubjanës dhe i revistës mujore “Medjunarodna politika” në Beograd etj. Në vitin 2000 u zgjodh kryeredaktor i gazetës “Dita”, pastaj redaktor i së përditshmes “Lajm” dhe redaktor në portalin “Koha.net” dhe nga viti 2014 në portalin “Lajmi.net”. Merret me përkthime nga gjuha sllovene në shqip dhe anasjelltas. (Zenun Çelaj)

STAVILECI Esat (1942 -2015). Jurist, profesor universitar, akademik. Lindi në Gjakovë, ku kreu shkollimin fillor dhe të mesëm, ndërsa Fakultetin Juridik në Prishtinë. Studimet



ESAT STAVILECI

pasuniversitare i përfundoi në Fakultetin Juridik të Universitetit të Zagrebit, më pas vijoi me studimet e larta të së drejtës krahasimtare në Francë, Itali dhe Holandë. U doktorua në Fakultetin Juridik të Universitetit të Sarajevës (1974). Prej vitit 1965 punoi në Fakultetin Juridik të Prishtinës deri në pensionim. Nga viti 2000 u zgjodh anëtar i rregullt i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Pos në Universitetin e Prishtinës, ligjëroi edhe në Universitetin e Tetovës, në Universitetin e Europës Juglindore në Tetovë dhe, si profesor-vizitor, në disa universitete të tjera. Ishte themelues dhe kryetar i Shoqatës për Teori dhe Praktikë Administrative, autor i shumë librave nga kjo fushë dhe njëri ndër autorët më produktivë në fushën e shkencës juridike-kushtetuese dhe politike. Në fushën shkencore juridike u paraqit që në vitin 1967, si pjesëmarrës në simpoziumin shkencor “Krahinat autonome në Jugosllavi”, dhe që atëherë, përreth gjysmë shekulli në shumë kumtesa dhe paraqitje publike do ta argumentojë mbrojtjen e pozitës kushtetuese të Kosovës dhe avancimin e statusit të saj në ish-Jugosllavi. Botoi edhe një numër librash autorialë dhe disa të tjerë si bashkautor, ndër të cilat: “Hyrje në shkencat administrative” (1997), “Nocione dhe parime të administratës publike, aspekte metodologjike dhe shqyrtime krahasimtare” (2005), “Shteti, shqyrtime të përgjithshme teorike me vështrim rasti i Kosovës” (2008), “Fjalor shpjegues i termave administrativë” (2010), “Në mbrojtje të pavarësisë së Kosovës” (1998), “Vazhdimësia e mendimit për Kosovën dhe çështjen shqiptare” (2001), “Kosova dhe çështja shqiptare në udhëkryqet e kohës” (2005) etj. Në vitin 2013 u botua përmbledhja e veprave të tij në njëzet vëllime. Ishte laureat i shumë çmimeve dhe mirënjohjeve. (Blerim Reka)

STAVILECI Masar (1935-2016). Studiues, përkthyes, profesor universiteti. Lindi në Gjakovë. Filloren e kreu në vendlindje, Shkollën Normale në Prishtinë, ndërsa studimet universitare në degën e gjuhës dhe të letërsisë frënge në Universitetin e Beogradit. Studimet pasuniversitare i vazhdoi në Zagreb dhe Paris. Në universitetin e Prishtinës mbrojti tezën e doktoratës rreth ndikimit të iluminizmit francez në letërsinë e Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Në fillim punoi si mësimdhënës i gjuhës frënge në shkolla fillore dhe të mesme, më vonë u bë ligjërues në Fakultetin Ekonomik dhe Juridik dhe pastaj profesor i letërsisë frënge në degën e gjuhës dhe të letërsisë frënge në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës. U mor me kritikë dhe studime letrare, kryesisht të autorëve klasikë frëngë të kohës së iluminizmit. U mor edhe me përkthime. Veprat e botuara: “Iluminizmi shqiptar në Letërsinë e Rilindjes Kombëtare Shqiptare” (1990), “Tema letrare franceze” (1996), “Apologji e çështjes shqiptare” (1998), “Iluminizmi shqiptar” (2000), “Elemente të stilistikës letrare” (2005). (Kujtim Rrahmani)

STAVILECI Musa (1948-). Inxhinier i ndërtimtarisë, profesor universiteti. Lindi në Gjakovë, shkollën fillore e përfundoi në vendlindje, të mesmen në Prishtinë. Kreu studimet e larta në Fakultetin Teknik të Universitetit të Prishtinës (UP) (1974), ndërsa studimet e magjistraturës në Fakultetin e Ndërtimtarisë të Universitetit të Zagrebit (1981). U zgjodh asistent në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe të Arkitekturës më 1972. Kreu specializimin në fushën e ndërtimtarisë në Moskë. Mbrojti disertacionin në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe të Arkitekturës të UP-së (1991), ku më pas u avancua në të gjithë titujt universitarë. Është autor i teksteve universitare: “Metoda e elementëve të fundmë në mekanikën e strukturave”, “Teoria e strukturave-stabiliteti”, “Teoria e sistemeve sipërfaqësore” etj. dhe autor e bashkautor i disa punimeve shkencore të botuara në Kosovë dhe jashtë saj. Ishte i angazhuar si profesor në Fakultetin e Shkencave të Zbatuara të Universitetit të Tetovës. Kreu detyra të ndryshme në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe të Arkitekturës, ishte shef i katedrës teoria e konstruksioneve dhe dekan i këtij fakulteti (2004-2009). (Fetah Jagxhiu).



MUSA STAVILECI

STEFANOVIQ-RAVASI Sllavoljub (Slavoljub Stefanović-Ravasi) (1927-1996). Regjisor.

Lindi në Çaçak (Serbi). Kreu studimet për regji në Akademinë e Arteve në Beograd. Më 1952 punësohet në Teatrin Popullor Krahinor në Prishtinë. Në këtë teatër ka bërë regjinë e disa shfaqjeve teatrale me trupën e dramës serbe dhe shqipe, si: “Të gjithë bijtë e mi”, “Ruj Bllaz”, “Njeriu i cili nuk ka ekzistuar”, “Pa të tretin”, “Tartufi”, “Menaxheria e qelqtë”, “Mësimi”, “Nëna Kurajë” etj. Krahas regjisë, luajti edhe si aktor në shfaqje dhe në role të ndryshme. Më 1958 u kthye në Beograd, ku deri në vitet ’90 bëri regjinë e shumë dramave dhe serialeve televizive. Më 1994 u rikthye në Teatrin Popullor Krahinor në Prishtinë, ku bëri regjinë e shfaqjes “I ndjeri” të B. Nushiqit. Njihet edhe si autor i disa skenarëve. Gjatë viteve ’90 punoi edhe në përgatitjen e regjisorëve të rinj serbë në Televizionin e Prishtinës. Vdiq në Beograd. (Bekim Lumi)

STELA DARDANE. Kategori e monumentit mbivarror. Për stelat dardane dihet vetëm nga periudha romake dhe ato kanë vlerë të madhe për studimin e artit dhe të arkitekturës



mbivarrorë të dardanët. Punimi i monumenteve mbivarrorë në gur nis pas pushtimeve romake dhe me depërtimin e kulturës romake, kur banorët vendës i përvetësuan dhe i punuan këto monumente për nevojat e tyre, duke u dhënë në këtë mënyrë një karakter provincial iliro-romak. Pjesa më e madhe e tyre u takon gjetjeve të rastit. Është karakteristike se me tipat, stilin dhe motivet e tyre stelat e kësaj treve, që nga rajoni i Shkupit, Kumanovës dhe

Pollogut e deri te hapsira e Nishit, Aleksincit, Knjazhevcit dhe e Ravnës përbëjnë një tërësi më vete brenda provincës së Mezisë së Epërme, duke u ndarë nga ato të pjesës veriore të saj. Ky tip stelash është quajtur “dardan”, i cili është mbizotërues dhe gati i vetmi sidomos në pjesën qendrore (Kosovë) dhe veriore dardane. Këto stela përbëhen nga tri komponente kryesore: 1. fusha relievore (nishes, edikulës), në pjesën më të madhe harkore dhe me figurat e të ndjerëve apo edhe me përkushtuesit e tyre; 2. fusha mbishkrimore e profiluar; dhe 3. xokolini, zakonisht të pakornizuar, në qendër të të cilit qëndron vazoja me dy vegje (amforë, kantar, krater), prej nga në të dy anët dalin në kornizë degët e hardhisë me vile, të urthit apo kombinimi i këtyre të dyjave. Degët qarkojnë tërë monumentin në faqen e parme. Ky lloj stelash, për dallim nga pjesa tjetër e provincës së Mezisë së Epërme ku ndeshet më pak, është mjaft i pranishëm në trevat fqinje ilire, siç janë disa lokalitete në brendi të provincës së Dalmacisë, si në trevën e Plevles, me koncentrim në Komin (Municipium S...), Prijepole dhe Beranë. Megjithatë, numri më i madh i tyre është zbuluar në trevën e Kosovës dhe në luginën e Timokut e të rrjedhës së poshtme të Moravës Jugore: Timak Minus dhe në territorin e Naisit. Përjashtim bën territori i Scupit, ku gjendet më pak dhe ku kanë qenë të fuqishme ndikimet nga Azia e Vogël dhe Greqia dhe ku janë të pranishme edhe stelat me ballinën trekëndëshe dhe ato me fushë relievore pesëkëndëshe, prej nga barten edhe në trevën e Kosovës. Për këtë arsye burimi i këtij motivi, në funksion të kornizës dekoruese, më me siguri kërkohet në Kosovë, në qendrën e territorit dardan. Domethënia simbolike e hardhisë së rrushit dhe e urthit është e qartë, se janë atributet kryesore të Dionisit, që tregon se në Dardani ka qenë mjaft i përhapur kulti i kësaj perëndie, nën të cilin fshihet perëndia vendëse e plleshmërisë, e afërt me Dionisin, me të cilin edhe është barazuar.

Pa marrë parasysh ndikimet nga jashtë, arti plastik i këtyre stelave ndërlihet me traditën ilire, ku në të shumtën e rasteve relievi përmban vija të qarta të ndikimit të punimit në drugdhendje. Kjo vërehet më së miri te bust-portretet, te të cilat në mënyrë të veçantë është shprehur karakteri autokton dhe ku mbizotëron relievi i sheshtë dhe linear. Njëherësh, te shumica e tyre vërehet një realizëm skematik

me një dozë shtangimi. Ky stil nuk është i pranishëm vetëm te stelat e trevës dardane, por edhe në trevat e tjera ilire, sidomos në brendi të provincës së Dalmacisë, ku analogji më e afërt ndeshet te stelat e Plevlës, te të cilat edhe figurat e të ndjerëve janë paraqitur vetëm në trajtë bust-portreti. Prania e fortë lokale veçanërisht shihet në veshjen e gruas, e cila më së shumti i bën rezistencë ndikimit romak. Pjesa më karakteristike e kësaj veshjeje është shamia dhe lidhësja për flokë nën të, kurse nga stolitë qaforja me tri medaljone, që është veçanti e trevës së Kosovës. Prodhimi i këtyre stelave u zhvillua nga mesi i shek. II - mesi i shek. III, por zgjati deri në fund të shek. III. Shfrytëzuesit e këtyre stelave kanë qenë banorë vendas, pa të drejta qytetare, ose banorë me të drejta qytetare romake, siç shihet prej emrave të tyre vetjakë, kurse pjesa tjetër ishin trakas, italikë, grekë dhe nga Azia e Vogël. (Exhlale Dobruna-Saliu)

STIPÇEVIQ Aleksandër (Stipčević Aleksandar) (1930-2015). Arkeolog, ilirolog, albanolog. Lindi në Arbanas të Zarës (Kroaci), shkollimin fillestar e kreu në Zarë dhe më 1954



ALEKSANDËR
STIPÇEVIQ

diplomo i në arkeologji në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Zagrebit. Më 1977 doktoroi në Fakultetin Filozofik të Zarës. Studioi artin dhe religionin e ilirëve, bibliografinë dhe historinë e librit dhe të bibliotekave. Shkroi sintezën e parë mbi artin ilir dhe sintezën për ilirët, e cila përfjetoi 9 botime në kroatisht, anglisht, shqip dhe italisht; shkroi për arbëreshët e Zarës dhe botoi një sërë shkrimesh në gjuhë të ndryshme. Fillimisht punoi në Muzeun Arkeologjik dhe në Institutin e Shkencave Historike në Zarë, pastaj në Bibliotekën Nacionale dhe Universitare të Zagrebit (1957), udhëhoqi Bibliotekën e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve (JAZU, 1974) dhe ishte kryeredaktor i "Leksikonit biografik kroat" të Entit Leksikografik "Miroslav Kërlezha". Në vitet 1970-1973 ligjëroi lëndën hyrje në arkeologji në Fakultetin Filozofik të Prishtinës, ndërsa në Universitetin e Zagrebit historinë e librit dhe të bibliotekave. Më 1987 u zgjodh profesor ordinar i Universitetit të Zagrebit, ku punoi deri në pensionim (1997).

Drejtoi katedrën për bibliotekari (1987-1996) në Fakultetin Filozofik në Zagreb, ishte kryetar i Shoqatës së Bibliotekarëve të Kroacisë etj. Në vitin 1983 u zgjodh anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave dhe i Arteve të Kosovës. Botoi shumë vepra, ndër të cilat veçojmë: "Arti tek ilirët" (1963), "Ilirët" (1966; shqip: 1967), "Bibliographia Illyrica" (1967), "Ilirët, historia, kultura, jeta" (1974), "Simbolet e kultit tek ilirët" (1981), "Historia e librit" (1985), "Interpretime albanologjike" (1994) "Fati i librit" (2000), "Kultura tradicionale e arbëreshëve të Zarës" (2013) etj. Librat e tij u përkthyen dhe u botuan në disa gjuhë, përfshirë edhe gjuhën shqipe, në Prishtinë dhe në Tiranë. Ishte laureat i shumë mirënjohjeve dhe dekoratave, ndër të cilat edhe i Medaljes së Artë "Naim Frashëri" dhe dekoratës "Skenderbeg", akorduar nga presidenti i Shqipërisë. (Edi Shukriu)

STOJANOVIQ (Stojanović) Radosav (1950-).

Shkrimtar i letërsisë serbe nga Kosova, gazetar. Lindi në Parunovac afër Krushevcit (Serbi). Studioi gjuhën serbokroate dhe letërsinë jugosllave në Universitetin e Prishtinës. Ishte mësues në gjimnazin e Prishtinës dhe më pas gazetar, redaktor dhe kryeredaktor i gazetës "Jedinstvo". Botoi librat me poezi: "Dorëshkrimi hidhur" (1982), "Shkolla e djallit" (1988), "Spiranca" (1993), "Dridhje" (2007), "Trashëgimia" (2014), "Po të kishte dashuri" (2015) etj. Botoi edhe një sërë përmbledhjesh me tregime dhe romane: "Shartimi i egër" (2002), "Hëna e anijes" (2005) etj. Mori disa çmime për veprën e tij letrare. (Ismet Marković)

STOJANOVIQ (Stojanović) Trajko (1934-2002).

Grafist, piktor dhe skenograf. Lindi në Prishtinë. Kreu Shkollën e Mesme të Artit në Pejë (1954), ndërsa Akademinë e Arteve Figurative në Beograd (1958). Në periudhën 1961-1971 punoi si skenograf në Teatrin Popullor të Prishtinës. Më pas, deri në vitin 1974, ishte skenograf në Teatrin Jugosllav të Dramës në Beograd, pastaj krijues i lirë deri në fund të jetës. U mor kryesisht me grafikë. Për 40 vjet krijimtarie la pas mbi 600 fletë grafike, me teknikën e akuatintës dhe me kolorit bardhezi. Preokupim i tij krijues ishin manastret dhe temat kishtarë. Që pas mbarimit të shkollës së mesme deri në fund të karrierës, organizoi 25 ekspozita personale dhe mori pjesë në shumë

ekspozita kolektive. Ishte fitues i një sërë çmimesh profesionale në Kosovë dhe në Serbi. Vdiq në Beograd. (Fatmir Krypa)

STOZHINIQ (Stožinić) Svetomir (1925-). Mjek, internist, kardiolog, profesor universiteti, akademik. Lindi në Priboj të Malit të Zi. Kreu studimet në Fakultetin e Mjekësisë në Beograd (1957), ku gjithashtu specializoi dhe mbaroi studimet pasuniversitare nga lëmi i kardiologjisë (1967). Pas specializimit punoi si shef i repartit të internistikës në Spitalin Rajonal në Mitrovicë. Me hapjen e Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë, kaloi në Klinikën e Sëmundjeve të Brendshme, ku për shumë vjet ishte edhe drejtor. Mbrojti tezën e disertacionit të doktoratës në Beograd në vitin 1975. I mori të gjithë titujt akademikë në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. Kaloi në Universitetin e Beogradit, si profesor i Fakultetit të Mjekësisë. Është anëtar i Akademisë së Shkencave të Serbisë dhe anëtar i jashtëm i akademive ruse dhe bullgare. Publikoi shumë punime shkencore, tekste universitare dhe monografi. (Ahmet Brovina)

STRABONI. Gjeograf dhe historian grek. Lindi rreth vitit 63 p. e. r. dhe vdiq rreth vitit 20 në Amasia të Pontit (Turqi). Pos tjerash, shkroi veprën më të njohur me titull "Gjeografia", e cila përbëhet nga 17 libra. Gjatë shkrimit u mbështet në veprat e autorëve para tij, siç ishin Artemidori, Eratosteni, Apollodori etj. dhe në vrotimet që i bëri pas udhëtimeve në Europë, Azi dhe Afrikë. Shkrimet e Strabonit janë burime të rëndësishme edhe për historinë dhe gjeografinë e trojeve ilire dhe dardane. Straboni është i pari që jep informacione mbi lokalizimin e dardanëve. Duke përshkruar shtrirjen territoriale të Peonisë, vë në pah faktin se ajo ndodhej në fqinjësi me Dardaninë. Ai përmend edhe disa fise që jetonin brenda këtij territori (Dardanisë) të njohur si galabrët dhe thunatët. Dardanët nga Straboni përmenden në kontekste të ndryshme, varësisht nga ngjarjet dhe përfshirjen e dardanëve në to. Ai flet në veçanti për mënyrën e të jetuarit të dardanëve, për artin, për muzikën dhe instrumentet që ata përdornin. Në mesin e shumë qyteteve të rëndësishme të kohës ai e veçon edhe Damastionin, por pa e specifikuar vendndodhjen e saktë të tij, mbetjet e të cilit pjesa më e madhe e studiuesve modern janë të mendimit se duhet kërkuar në territorin

e dikurshëm të Dardanisë. (Emine Kalaja-Hajdari)

STRATEGU. Person që kishte funksion të lartë ushtarak ose funksion të lartë në shoqëri-në civile të Perandorisë Bizantine. Bashkë me emërtimin *strateg*, ishin në përdorim edhe emërtimet *monstrateg* dhe *hipostrateg*. Në hierarkinë e organizmit ushtarako-administrativ, strategu shfaqet që nga shek. VII, me riorganizimin e ushtrisë bizantine. Funksioni i tij ishte ekuivalent me rangun e guvernatorit suprem të një province, i cili mbante kontakte të drejtpërdrejta me perandorin bizantin. Kompetencat e strategut ishin të mëdha dhe ato shprehnin dominimin e autoriteteve ushtarake në raport me ato civile. Në gjysmën e parë të shek. X strategu filloi të humbë rëndësinë e mëparshme. Zgjerimi i Bizantit në brendësi të Ballkanit do të vazhdojë me sukses pas fitoreve mbi shtetin e Bullgarisë, përkatësisht të Maqedonisë (1014-1018), kështu që do të krijohen njësi të tjera më të mëdha ushtarako-administrative në këto zona, të cilat nuk kryesoheshin më nga strategët, por nga *duka* ose *katepani*. Megjithatë, pikërisht në këtë kohë përmendet edhe strategu i Shkupit, i cili administronte provincën e Dardanisë. Me reformat e dinastisë Komnene strategu kishte humbur rëndësinë që kishte. Në cilësi të regjentit provincial për herë të fundit strategu përmendet në vitin 1124. Në burime tregimtare, ndërkaq, përmendet deri në rënien përfundimtare të Perandorisë Bizantine. (Hamdi Mediu)

STREHIMORET. Institucione të përkujdesjes sociale dhe edukative për strehim të përkohshëm ose afatgjatë të njerëzve në nevojë. Këtu bëjnë pjesë strehimoret për fëmijë që janë viktimë të dhunës në familje dhe kanë nevojë për mbrojtje dhe shërbime të tjera. Strehimore të tilla ka në Gjakovë, Gjiilan, Mitrovicë, Pejë, Prishtinë dhe Prizren. Këto institucione u ofrojnë viktimave strehim, ushqim, veshmbathje, përkujdesje shëndetësore, këshilla psiko-sociale, aktivitete artistike, sportive, arsim profesional për t'u inkuadruar në jetë dhe në punë etj. Ato organizojnë edhe veprimtari sensibilizuese në mjedis të ndryshme sociale për vetëdijesimin e qytetarëve kundër dhunës në familje dhe në shoqëri. Në Kosovë ka edhe strehimore të tjera, siç janë edhe shtëpitë (azilet) e pleqve, si qendra për strehimin e qytetarëve të moshës së

tretë, të cilët, për shkaqe të ndryshme, janë të detyruar të strehohen në institucione të tilla të përkujdesjes sociale. (Majlinda Gjellaj)

STRELLCI Riza (1904-1947). Mbledhës i folklorit dhe këngëtar, nismëtar i përhapjes së librit shqip në Kosovë. Lindi në fshatin Tërbufc, afër Janjevës. Ishte një krijues dhe rikrijues i këngëve të njohura historike. Në vitin 1945 u bë anëtar i Lëvizjes Nacional-Demokratike Shqiptare dhe mori pjesë në Kongresin e Lipovicës (1946). Për këtë arsye u burgos dhe vdiq në Burgun e Nishit më 1947. Riza Strellci ishte rapsod popullor, që këndoi nëpër oda, por shkroi edhe vjersha me tematikë sociale. Ishte edhe mbledhës i këngëve epiko-historike. Një pjesë e trashëgimisë së tij poetike në frymën e këngëve popullore u botua si vepër e veçantë nën përkujdesjen e folkloristit Halil Kajtazi. (Vlorë Fetaj-Berisha)

STREZOCI. Fshat në komunën e Kamenicës, 13 km në veriperëndim të qendrës komunale. Shtrihet në rrjedhën e epërmetë lumit Krivareka. Në regjistrimin e fundit (2011) u evidencuan 267 banorë, kundrejt 418 banorëve që kishte në vitin 1948. Deri në vitet '90 të shekullit të kaluar veprimtari kryesore ekonomike ishte xehetaria. Shumë banorë të këtij vendbanimi ishin të angazhuar në xeheroren e magnezitit. Tani veprimtari kryesore janë pylltaria dhe blegtoria. (Muhamed Kallaba).

STRUGA (Dibra) Ali Murteza (1878-1937). Mjek, atdhetar. Lindi në Dibër, shkollën filllore dhe të mesme i kreu në Strugë. Kreu studimet në Universitetin Francez të Mjekësisë në Stamboll (1910). Pas diplomimit u kthye në Strugë, ku ushtroi profesionin e mjekut dhe njëkohësisht hapi farmacinë e tij. Në vitin 1912 u zgjodh delegat i Strugës për në Kuvendin e Vlorës, ku firmosi Deklaratën e Pavarësisë. Në vitin 1920, përsëri si delegat i Ohrit dhe i Strugës mori pjesë në Kongresin e Lushnjës. Më pas ka qenë drejtor i spitalit të Peshkopisë (1930-1934). Në vitin 1934 u dërgua në Kavajë, më vonë në Lushnjë, Elbasan dhe në fund në Lezhë. Në vitin 1935 e transferuan me punë në Tiranë, ku vdiq disa muaj para 25-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë. (Isuf Dedushaj)

STRUKTURAT E POPULLSISË. Tërësia e njerëzve që përbëjnë popullsinë është heterogjene si në aspektin përmbajtësor, ashtu

edhe në atë statistikor. Vetë individët dallojnë midis tyre nga shumë veçori, si: moshë, gjinia, gjendja materiale, statusi social, profesioni, niveli i arsimimit dhe një sërë veçorish të tjera individuale. Popullsia e Kosovës ka specifikat e veta, sa i përket strukturës. Sipas të dhënave të regjistrimit të vitit 2011, në Kosovë jetojnë 874,814 meshkuj dhe 863,588 femra, apo 50.3% meshkuj dhe 49.7% femra. Sipas strukturës së moshës, në Kosovë dominojnë grupmoshat e reja, me bazë të zgjeruar të piramidës së popullsisë sipas moshës. Numri i përgjithshëm i popullsisë nën moshën 6 vjeç është 179,648 banorë, apo 10.3% e popullsisë së përgjithshme. Struktura arsimore e popullsisë së Kosovës dallohet për një sërë veçorish: numri i personave me shkollim të lartë dhe superior është 116,912, apo 8.2% e popullsisë së përgjithshme mbi 10 vjeç; me shkollim të mesëm të lartë janë 427,905 banorë, ose 29.94%; me shkollim të mesëm të ulët janë 501,617 banorë, ose 35.10%; me shkollim fillor janë 245,552 banorë, ose 17.18%, ndërsa numri i popullsisë pa arsimim formal është 82,188 banorë, ose 5.75% e numrit të popullsisë së përgjithshme mbi 10 vjeç. (Hazer Dana)

STUBLLA Shemsije (1966-). Basketbolliste. Lindi në Prishtinë, ku kreu shkollimin fillor dhe të mesëm. Kreu studimet për gjuhë dhe letërsi angleze në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës. Karrierën si basketbolliste e nisi te KB "Universiteti" në vitin 1981, ku luajti për Prishtinën deri në vitin 1989. Në vitet vijuese e vazhdoi karrierën në Slloveni, në fillim te KB "Marles" në Maribor (1989-1993), pastaj te KB "Odeja Marmor" të Shkofja Llokës (1994-2001). U licencua si trajnere për kategoritë e reja në Fakultetin për Kulturë Fizike në Lubjanë (2007). Punoi edhe si trajnere në basketboll te skuadra "Triglav" e Kranjtit (2007-2008). (Leutrim Mustafa)

STUBLLA. Fshat në lindje të Vitisë, rreth 16 km nga qendra komunale. Shtrihet në trekufirin Kosovë-Serbi-Maqedoni. Ka lidhje të mira rrugore me qendrën komunale të Vitisë. Është vendbanim i tipit të shpërndarë, në lartësi mbidetare 700-800 m. Është vendbanim i vjetër, që e dëshmojnë gjetjet e shumta arkeologjike. Stublla si vendbanim përmendet edhe në defterin kadastral të vilajetit Vëllk të vitit 1455, ndërsa me emrin Stuba përmendet

në defterin kadastral të sanxhakut të Vushtrrisë. Derisa në vitin 1948 kishte 751 banorë, në vitin 2011 kishte 1,128 banorë. Popullsia merret me bujqësi dhe blegtori. Ka shkollën 9-vjeçare, stacionin shëndetësor, shtëpinë e kulturës, muzeun, disa njësi tregtare etj. (Shpend Agaj)

STUDENÇANI. Fshat në komunën e Suharekës, 5.5 km në perëndim të qytetit. Shtrihet në bregun e djathtë të lumit Toplluha, në lartësi mbidetare 350-450 m. Është vendbanim i tipit të dendur. Shtrihet pranë rrugëve Suharekë-Mamushë dhe Suharekë-Rahovec. Është vendbanim i lashtë, që dëshkohet nga gjetjet e ndryshme arkeologjike (pllakë mermeri me relief, vegla puna, mulli etj.). Është gjetur edhe një pitos i periudhës romake. Mes dy luftërave botërore në fshat kishte kolonë serbë, të cilët u shpërngulën pas Luftës së Dytë Botërore. Në vitin 1948 kishte 169 shtëpi me 1,172 banorë, kurse sipas regjistrimit të vitit 2011, në këtë vendbanim ishin të pranishëm 3,311 banorë. Një numër i konsiderueshëm jeton jashtë Kosovës. Dikur vendbanimi shtrihej rrezë kodrës Grab, ndërsa sot shumë shtëpi të reja janë ndërtuar në rrafshin aluvial të Toplluhës. Ka funksionin e bashkësisë lokale për vendbanimet përreth. Popullsia merret kryesisht me bujqësi, vreshtari, ndërtim etj. Ka shkollë 9-vjeçare, qendren e mjekësisë familjare, njësi të tregtisë, njësi për prodhimin e materialit ndërtimor etj. (Valbon Bytyçi)

STUDENICA Myrteza (1947-2011). Gazetar. Lindi në Pejë, ku kreu shkollën fillore dhe të mesme. Studimet i nisi në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Beogradit, ndërsa i përfundoi në Universitetin e Prishtinës. Punën e gazetarit e nisi në "Rilindje" më 1972, pastaj e vazhdoi në "Bujku", deri në mbylljen e kësaj gazete. Është autor i disa librave për lojën e shahut "Shah" (1988), pastaj "Abetarja e shahut" (1997) dhe "Rregullat e shahut" (1998), i revistës "Gazeta e shahut" (1997) dhe i librit "Shqiptarët dhe hebrenjtë" (1997), në të cilin u përfshi edhe një fjalor shqip-hebraisht. Ishte anëtar dhe themelues i Komitetit Kosovar-Hebraik dhe i shoqatës rajonale të shahut në Prishtinë. (Zenun Çelaj)

STUDIMET DIAKRONIKE TË SHQIPES. Studimet e ndryshimeve gjuhësore nëpër kohë në rastin e shqipes kanë qenë shumë të

rëndësishme qysh nga fillimet e studimeve krahasuese (te F. Bop, R. Rask), kur u vunë themelet e vendosjes shkencore të shqipes brenda grupit të gjuhëve indoeuropiane. G. fon Han më vonë u mor me aspekte të ndryshme të historisë së gjuhës shqipe, ashtu si F. Mikloshiq e të tjerë. Qe G. Majeri ai që i shpuri më tej studimet diakronike të shqipes, qoftë në fushën e fonetikës historike, të gramatikës historike, apo të etimologjisë. Më tej ndihmesa me peshë në fushën diakronike solli H. Pedersen, ndërsa N. Jokli bëri një sintezë të re, duke i shpënë ato ndjeshëm përpara, sidomos në fonetikë dhe në etimologji. Studimet diakronike të shqipes janë ndjekur në kuadër të studimeve krahasimtare dhe më vonë të historisë së gjuhëve indoeuropiane. Janë shquar ndihmesat e autoriteteve si H. Bariq, P. Skok, V. Cimohovski, A. Desnickaja, E. P. Hamp, C. Taliavini, M. Huld, V. Orel, S. Man, etj. Në kohët e vona ndihmesa kanë sjellë G. Klingenschmitt, Shumahr, J. Macinger etj. Në traditën shqiptare janë shënuar depërtime në studimet diakronike qysh herët me Dh. Kamardën në sh. XIX, pastaj M. La Piana e studiues të tjerë arëbreshë. Në kohën tonë tek arbëreshët e Italisë është krijuar një shkollë e studimeve tekstore e filologjike, ku, pas F. Solanos, M. Schiambras, shquhen F. Altimari dhe M. Mandalà. Altimari është marrë dhe me studime në fushën e historisë gramatikore. Në albanologjinë shqiptare ballkanike qysh herët shquhet ndihmesa e A. Xhuvanit, ndërsa me shfaqjen në skenën e studimeve të tilla të E. Çabejt ato morën një dimension dhe zhvillim të ri. Çabej ka bërë një sintezë të re për historinë e përgjithshme të gjuhës shqipe dhe për raportet e saj me gjuhët e tjera indoeuropiane, në një anë, dhe ballkanike, në anën tjetër. Na ka dhënë fonetikën e parë historike të shqipes me shumë raporte të reja, duke vendosur një standard të ri në këto studime. Ka bërë dhe studime për morfologjinë historike, me depërtime serioze me veprën për shumësin e singularizuar. Çabej ka bërë studimet më të gjera etimologjike për shqipen dhe ka hartuar fjalorin etimologjik. Në studimet e gjuhës së shkruar ai ka vendosur standarde të reja në filologjinë shqiptare me veprën për Buzukun dhe me botimin kritik të "Mesharit". Çabej mbetet studiuesi më i rëndësishëm i çështjeve të fazave të hershme të shqipes, të prejardhjes së saj dhe të vendit

të saj në kuadrin indoeuropian. Studime të rëndësishme diakronike në Shqipëri ka lënë M. Domi, sidomos në fushën e morofologjisë historike, ku gjithashtu njëryjë të posaçme e përbëjnë studimet e S. Rizës për sistemin e rasëve, për nyjat, për përemrat dhe foljet. Me këto studime kemi një përpjekje të re për vështrimin teorik të problemeve, për ndarjen më të rreptë të vështrimit diakronik nga ai sinkronik në fushën e gramatikës historike. Domi ka sjellë ndihmesa me vlerë edhe lidhur me raportet e shqipes me gjuhët e Ballkanit të lashtë. Afërsisht në këtë kohë kemi studimet e M. Camajt për aspektet historike të fjalëformimit të shqipes, ashtu si për tekstet e vjetra, konkretisht për “Mesharin” e Buzukut. Në brezin pas Domit, Sh. Demiraj shquhet me një vështrim të përgjithshëm të zhvillimeve të shqipes, sidomos në fushën e gramatikës historike, me studimet sintetizuese në fushën e fonetikës historike dhe të historisë së jashtme të shqipes. Në brezin e fundit me studime po kështu sintetizuese dhe në kuadër të metodave tradicionale është shquar K. Topalli, si në fushën e fonetikës historike, ashtu edhe në fushën e gramatikës. Ai tani ka bërë dhe një fjalor etimologjik të shqipes. Tradita e studimeve diakronike në fushën e gramatikës në Shqipëri është ndjekur në hulumtimet e E. Likës, sidomos në fushën e sistemit emëror, të S. Mansakut e të tjerëve. Në brezin më të ri është shquar B. Demiraj me studimet etimologjike, me studimet në fushën e zhvillimeve fonetike dhe në fushën e historisë tekstore. Me zhvillimet gjuhësore në rrafshin dialektor janë marrë J. Gjinari, B. Beci e të tjerë. Studimet diakronike për shqipen në Kosovë kanë nisur po ashtu qysh herët: S. Riza me veprën “Fillimet e gjuhësisë shqiptare” dhe me studimin për pronorët i kishte nisur këto studime, për t’i vazhduar më me ngulm pastaj në Tiranë. I. Ajeti shquhet si shtylla themelore e studimeve diakronike të shqipes në Kosovë, fillimisht me studimet në fushën e dialektologjisë historike me studimet për të folmen e Arbneshit të Zarës në raport me të Krajës, për të folmen e Gjakovës, ndërsa më vonë me studimet etimologjike dhe të kontakteve të shqipes me gjuhët ballkanike dhe sidomos sllave. Qysh në vitet ’60 të shek. XX ai erdhi me “Morfologjinë historike”, që do të jetë një nga veprat e rëndësishme në

këtë fushë. Ajeti ka dhënë një ndihmesë dhe në fushën e onomastikës. Studimet e tij kanë qenë orientuese në këto fusha për një kohë të gjatë në Kosovë. Në fillimet e tij ai punonte në vijëçn e H. Bariqit edhe të P. Skokut, ndërsa më vonë tërësisht në hullinë e Çabejt. B. Bokshi me “Rrugën e zhvillimit të sistemit nominal të shqipes” solli një vështrim krejt të ri në studimet diakronike të gramatikës së shqipes, duke ndjekur sistematikisht zhvillimet në sistemin emëror me metodën strukturale, të pazbatuar më parë. Këto studime Bokshi i zgjeroi me veprat për nyjat në gjuhët e Ballkanit, për përemrat dhe për pjesoren e shqipes. Studime diakronike në fushën e fonetikës së shqipes, të teksteve të vjetra dhe sidomos të historisë së shqipes në raport me gjuhët e Ballkanit, të prejardhjes së gjuhës dhe të raporteve të shqipes me gjuhët sllave e me rumanishten, me vështrime të gjuhësisë moderne nga strukturalizmi e te sociolinguistika ka sjellë R. Ismajli, i cili ka bërë dhe një histori të zhvillimeve në fushën e gjuhës standarde. Studime në fusha të onomastikës me vështrim historik kanë dhënë S. Gashi, R. Doçi, Sh. Sejdiu, R. Ushaku, B. Baliu, etj. Q. Murati është marrë dhe me vështrime etimologjike dhe me raportet e shqipes me maqedonishten e arumanishten. R. Mulaku ka dhënë ndihmesë për studimin e gjuhës së autorëve të vjetër shqip. (Bardh Rugova)

STUDIMET DIALEKTOLOGJIKE TË SHQIPES. Kanë filluar para Luftës së Dytë Botërore nga studiuesit e huaj, që kryesisht u morëm me studimet e të folmeve të diasporave: arbëreshe, arvanite dhe arbneshë. Mirëpo, pas Luftës së Dytë Botërore studimet e dialekteve të shqipes u përqendruan brenda Shqipërisë dhe Kosovës, duke vazhduar pastaj me një intensitet më të ulët edhe në Maqedoni. Në fillim u bënë studime gjuhësore rreth të folmeve të arbërorëve (arvanitëve) të Greqisë (H. Pedersen, Furiki, Vajgandi, për të folmet e italo-arbëreshëve (M. Lamberci), për të folmen e arbneshëve të Zarës (Buzoviçi, T. Erberi, F. Mikloshiçi, G. Vajgandi e K. Taljavini). Brenda Shqipërisë gjejmë përshkrime dhe shpjegime të kësaj faze të hershme të studimeve dialektore nëpër gramatika të shqipes nga të huajt. Në Gramatikën e Hanit gjejmë të dhëna mbi të folmen e Rrëzës së Përmetit, në atë të Dozonit mbi të folmen e Zagorisë, te Vajgandi

përshkruhen tiparet e të folmeve të Shqipërisë së Mesme, kurse Gramatika e Kristoforidhit (1882) pasqyron veçori të toskërishtes. Pekmezi në Gramatikën e tij (1913) për bazë e kishte të folmen e Elbasanit. G. Louman trajtoi sistemin tingullor të shqipes, mbështetur në të folmen e Shkodrës. Lamberci nuk u ndal vetëm në studimin e arbëreshëve të Italisë.

Për të folmet shqipe të Jugosllavisë, me përjashtim të Arbëneshtit të Zarës, për të cilin ka të dhëna shumë më herët, studimet e para të mirëfillta në këtë fushë i kemi midis dy luftërave botërore. Ato kanë filluar me një parashtrësë të N. Joklit për të folmen e Rapçishtit, pastaj P. Skoku botoi studimin për të folmen e shqiptarëve të Luginës së Shkupit, ndërsa K. Taljavini për shqiptarët e Dalmacisë (1937) dhe për gegërishten lindore të Maqedonisë (1942). Çimohovski, ndërkaq, botoi një monografi për të folmen e Dushmanit (1951). Për këtë periudhë të studimeve dialektologjike të gjuhës shqipe ka zotëruar zgjedhja personale e studiuesve, pa pasur ndonjë projekt të caktuar. Pas kësaj vjen faza e dytë e studimeve dialektore e shqipes, që karakterizohet me një organizim të planifikuar, kryesisht nga studiuesit e Shqipërisë, që këto materiale u botuan në "Buletin i shkencave shoqërore", "Studime filologjike" pastaj në përmbledhjet e shtatë vëllimeve me titull: "Dialektologjia shqiptare, I, II, III, IV, V, VI, VII" në Tiranë. Këto studime u drejtuan nga Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë me studiuesit: J. Gjinari, Gj. Shkurtaj, S. Floqi B. Beci, M. Çeliku, Sh. Hoxha, M. Totonj Q. Haxhihasani, Gj. Gosturani, J. Thomaj, E. Lafe, T. Osmani, P. Zeneli, H. Xhaferri, F. Muça, Ç. Petriti, N. Mërkuri e të tjerë. Në fund të viteve '60 të shek. XX, A. Desnickaja publikoi studimin me titull "Gjuha shqipe dhe dialektet e saj" (Albanskij jazyk i ego dialekty, Leningrad 1968), ku jepet një pasqyrë e detajuar e dialekteve të shqipes në përgjithësi. Në Kosovë ndihmesa të rëndësishme në studimin e dialekteve kanë dhënë: I. Ajeti, L. Mulaku, M. Halimi, F. Raka, F. Sylejmani, I. Badallaj, M. Bardhi, M. Ahmetaj, H. Kelmendi, T. Kelmendi, N. Pajaziti, A. Zyberi etj. Ndërsa në Maqedoni: F. Sylejmani, Z. Osmani, R. Nesimi, Q. Murati, A. Zenku, H. Ymeri, etj. Në Kosovë u botuan një varg studimesh dialektore në "Gjurmime albanologjike" dhe në revista të tjera me karakter të tipit të skicës dhe të

mesëm, por shumë më herët se në Shqipëri, në Jugosllavi (kryesisht në Kosovë e më pak edhe në Maqedoni) janë studiuar disa nga të folmet me tërë sistemin fonetik dhe gramatikor. Tipi i monografisë u gjet si tipi më i qëlluar dhe gjithëpërfshirës për përshkrimin dhe shpjegimin e tipareve të njësive të ndryshme dialektore.

Për të folmet italo-arbëreshe kanë qenë të interesuar shumë gjuhëtarë, si: M. Lamberc, E. Çabej, E. Hemp, M. Camaj, M. La Piana, G. Petrota, F. Solano, M. Shambra, L. M. Savoia, F. Altimari, M. Mandala, V. Broj, A. Guxeta, I. Badallaj, Gj. Shkurtaj, K. Kamësi, M. Masaro, E. Lika, L. De Rosa, G. Turano, A. Rotondo etj. Për të folmet arvanite të Greqisë po përmendim: K. H. Rainhold, A. Furiki, K. Hebler, H-J. Zase, E. Hemp, T. P. Johalas etj. Për të folmet e shqiptarëve të Ukrainës, përveç disa studimeve nëpër revista, I. Voronina, M. Domosileckaja dhe L. Sharapova publikuan monografinë, që u përkthye edhe në gjuhën shqipe me titull: "E folmja e shqiptarëve të Ukrainës" (Shkup, 1996). Kohët e fundit studiues të albanologjisë në Universitetin e Shën Peterburgut kanë kryer disa ekspedita për studimin e të folmeve shqipe në Ukrainë. B. Sokolova është marrë për shumë vjet me të folmen e shqiptarëve të Mandricës në Bullgari, që si produkt i hulumtimit të saj për këtë idiomë dialektore panë dritën disa studime në gjuhën bullgare, frënge dhe në fund edhe në gjuhën gjermane. (Imri Badallaj)

STUDIMET E STRUKTURËS SË SHQIPES.

Studime që trajtojnë strukturën e gjuhës. Mbështeten në konceptet e gjuhësisë bashkëkohore, të nisura nga Sosyri, që kanë rezultuar me strukturalizëm dhe fusha të dala prej saj, përfshirë gjenerativizëm, teori të optimalitetit dhe poststrukturalizëm: zgjerim të studimeve gjuhësore në sociolinguistikë, psikolinguistikë ose tekst. Ndër studiuesit e parë strukturalistë të shqipes mund të konsiderohet Erik Hemp, që në vitet pesëdhjetë. Studimet gjenerativiste të shqipes nisin me Oda Buholc dhe me Bevingtonin në fund të viteve gjashtëdhjetë dhe në fillim të atyre shtatëdhjetë. Buholc në trajtim gjenerativ ka shqyrtuar rimarrjen e kundrinës në gjuhën shqipe, ndërsa Bevington ka trajtuar fonologjinë e shqipes. Një gramatikë strukturale të shqipes e ka hartuar Njumark, ndërsa këndvështrimi struktural mbështetet edhe te gramatika e shqipes e Buholcit dhe e

Fidlerit, e botuar më 1987. Thuajse të gjitha studimet e mëtutjeshme të shqipes nga autorë të huaj kanë pasur trajtim qoftë struktural, qoftë gjenerativ. Ndër autorë shqiptarë, studimet e para strukturale të shqipes realizohen nga B. Bokshi dhe R. Ismajli. Bokshi ka trajtuar në një artikull të vitit 1971 rrugën e fleksionit nominal të shqipes, duke u mbështetur në analizën sintagmatike, sipas nocioneve të gloseantikës së Hjelmslevit. Ismajli, duke qenë student i Martinesë, që në fillim të viteve shtatëdhjetë sjell një varg studimesh të mbështetura në konceptet strukturale dhe poststrukturale. (Bardh Rugova)

STUDIMET FILOLOGJIKE TË SHQIPES.

Përfshin tërësinë e shkencave që studiojnë gjuhën dhe krijimtarinë letrare të një populli. Në një kuptim më të specifikuar filologjia është dije historike, që ka për synim njohjen e qytetërimeve të kaluara, përmes dokumenteve të shkruara që na kanë lënë ato. Botimi i teksteve është preokupimi themelor i filologëve. Në traditën shqiptare përdorimi në kuptimin e parë ka qenë më i përhapur. Studimet filologjike të shqipes në kuptimin e gjerë të fjalës janë lidhur me studimet për gjuhën shqipe. Studimet filologjike të shqipes ndahen në tri etapa: 1944-1954, 1955-1966 dhe 1967-. Etapa e parë përshkohet nga kodifikimi i gjuhës letrare, përcaktimi i terminologjisë shkencore e shkollore; etapa e dytë përfshin studimet në fushat e gramatikës, fjalëformimit, leksikologjisë, që krijojnë bazat tekniko-shkencore, ndërsa etapa e tretë përfshin hartimin e veprave si: fjalori njëvëllimësh, fjalori shumëvëllimësh, fonetika e gramatika, studimet etimologjike. Ndër studimet, institucionet dhe revistat kryesore filologjike shqiptare kronologjikisht mund të radhiten: "Gramatika", "Fjalori", "Fjalori drejtshkrimor", "Atlasi dialektologjik", botimi i Seminarit, "Gramatika" e Akademisë, "Standard Albanian" nga Njumark, Prifti, Habard; "Albanische Gramatik" e O. Buholcit dhe V. Fidlerit; "Gramatika" e Camajt, "Gramatika" e Resultit, "Manuali" i Solanos etj. Analizat fonologjike (Dodi, Ismajli, Beci, Gjinari), gjymtyrimi aktual i fjalisë (Floqi), sprovat për zbatimin e teorisë së thënies nga Kelmendi e Përnaska; ndonjë analizë tekstore (Ismajli); studimet strukturale në histori të gjuhës të Bokshit, por edhe studimet tradicionale, si ato të Rizës për foljet; studimet e his-

torisë së gjuhës e ato etimologjike të E. Çabejt, Hahnit, Majerit, Joklit, Noççës e Pedersenit. Studimet e Çabejt krijuan bazë për etimologët indoeuropianistë dhe bashkë me hulumtimet e autorëve si Tagliavini, Desnickaja, Çimohovski, Xhuvani, Ajeti, Hemp, Hald, Klingenshmit, Ëlberg krijuan gjendjen në të cilën, një shekull pas fjalorit etimologjik të Majerit, tashmë kemi sprovën e Huldit (rreth 200 baza), disa fjalorë të rinj etimologjikë: të B. Demirajt 1997 (mbi 400 baza), të V. Orelit 1998 më të gjerë dhe të J. Erat. Veprat sintetizuese për historinë e shqipes: nga Riza (1952), Bariq (1955), Çabej (1961), Domi (1962), Ajeti (1965), Man (1977); "Gramatika historike", "Gjuha shqipe dhe historia e saj" dhe "Fonologjia historike" e Demirajt; veprat sintezë të Bokshit për zhvillimin e sistemit të rasave, për nyjat, për pjesoren, për vetorët; vepra sintezë e K. Topallit "Fonetika historike e shqipes"; hyrjet e dobishme të Pellegrinit e të Macingerit; studimet e veçanta të Hempit, Çimohovskit, Desnickajas, Mansakut. Vështrim tjetër është "Gjendja e sotme e studimeve albanologjike - rezultate dhe probleme" e I. Ajetit, studimet e I. Popoviqit për "karakterin dhënës të shqipes". Botimi i revistave: "Gjurmime albanologjike", "Buletin i Fakultetit Filozofik", "Studia humanistica"; organizimin dhe botimin e Seminarit; themelimin e institucioneve shkencore-universitare, të instituteve Albanologjik dhe të Historisë, Konsulta Gjuhësore e Prishtinës etj. Studimi i huazimeve të shqipes nga latinishtja (Çabej, Mihëjesku, Harman, Kristofson, Rosi-Landi, Bone etj.; huazimet orientale-turke (Borecki, Dizdari); huazimet sllave dhe anasjelltas (Ajeti, Gjinari, Svane, Stanishiq, Ylli, Murati, Blaku, Ismajli etj.); vrojtme preskriptiviste e sociolinguistike (Kostallari, Ismajli, Beci, Nuhiu, Shkurtaj, Munishi, Paçarizi, Çeliku, Lafe, Osmani, Vehbiu, Altimari, Cicipis etj.); studimet dialektologjike (Ajeti, Gjinari, Njumark, Beci, Totoni, Çeliku, Shkurtaj, Agani, Halimi, Badallaj, Raka, Nesimi, Osmani, Hebler, Hemp, Zase, Johalas, Camaj, Altimari, Gjordan, Solano, Savoia, Turano, Sokolova, Voronjina etj.). Studimet fonetike e fonologjike dhe akustike (Dodi, Beci, Hemp, Ismajli, Halimi, Bellusho, Kolgini); studimet e teksteve të vjetra, si: botimi kritik, interpretimi, komentet dhe studimi i "Mesharit" të Buzukut, veprës së Matrëngës, të Budit, i Dorëshkrimit të Grottaferratës, i Kuvendit të Arbënit, i veprës së Bogdanit, Kazazit, Bardhit, të humanistëve,

Varibobës, të Naimit etj. (Rok, Mjeda, Rrota, Çabej, Resuli, Riza, Camaj, Ashta, Ajeti, Shambara, Sulejmani, Mandala, Macinger, Svane, Ismajli, Omari, Arapi, Sedaj, B. Demiraj, Fidler, Schumacher-Macinger, Altimari, Fortino, Belmonte, Myderrizi, Ajeti, Kaleshi). Studimet e shqipes në raport me gjuhët ballkanike (Çabej, Xhuvani, Domi, Ajeti, Demiraj, Bokshi, Fridman, Fiedler, Xhozef, Savicka, Mansaku, Thomai, Ismajli; studimet onomastike (Çabej, Ajeti, Çimohovski, Demiraj, Sejdiu, Doçi, Ushaku, Luka etj.); studimet filologjike të letërsisë veçohen me veprat “Hiostoria e letërsisë; “Historia” e Akademisë; “Historia” e Skiroit; “Historia” e Qosjes për romantizmin; studimet e A. Pipës, studimet e I. Rugovës, A. Aliut, H. Hamitit etj. Qendra të studimeve filologjike të specializuara veçohen: Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Instituti Albanologjik, departamente studimesh në universitete, qendra universitare si Shkodra, Elbasani, Korça, Gjirokastra, Tetova, Shkupi, universitetet e Kalabrisë, Sicilisë, Napolit, Barit, Romës, Munihut, Shën Peterburgut, Torunjit, Çikagos etj. Botohen revista si “Studime filologjike”, “Studia albanica”, “Gjurmime albanologjike”, “Seminari”, “Buletin i Shkodrës”, “Gjuha jonë”, “Gjuha shqipe”, “Filologji”, “Studime”, “Studime albanologjike”. Së fundi u themelua Këshilli Ndërkademi i Gjuhës Shqipe nga Akademia e Kosovës dhe Akademia e Shqipërisë, i cili ka për qëllim të hulumtojë gjendjen aktuale të shqipes dhe praktikisht të hetojë rastet ku ndihet nevoja për ndonjë ndryshim në standardin e shqipes, sidomos në fushën e kulturës së gjuhës e të leksikut. Për të përmbushur mungesat e informimit ASHAK-u botoi veprat e albanistëve të traditës: veprat e Rizës, Ajetit, Pedersen-it, Çimohovskit, Mikloshçit, Hempit, Joklit etj. Projekt tjetër është krijimi i bazës së të dhënave të shqipes së shkruar. (Mensur Vokri)

STUDIMET FUNKSIONALE TË SHQIPES.

Nga aspekti i gjuhësisë funksionale, në Kosovë ka pasur zhvillime me interes, sidomos në fushën e studimeve fonologjike të nisura nga R. Ismajli, pastaj nga H. Halimi, dhe të vazhduara më tej. Ky orientim është përkrahur dhe në Shqipëri (Gjinari, Dodi, Beci). Është botuar dhe vepra themelore në këtë drejtim e A. Martinesë: “Elemente të gjuhësisë së përgjithshme” (përktheu R. Ismajli, 1974). Gjuhësia sistemike-funksionale i nxjerr në pah

dimensionet kontekstuale të gjuhës dhe e sheh atë si semiotikë shoqërore. Bazohet në modelin e gjuhësisë funksionale të zhvilluar nga M. A. K. Hallidaj (1973, 1978, 1994), me klasifikimin në tri funksione, atë ideacional, ndërpersonal dhe tekstual, që rimerr klasifikimin e Bylerit po ashtu në tri funksione (1934), atë shprehës, konativ dhe referues, e që Jakobsoni (1960) e përpunoi, duke shtuar edhe tri funksione të tjera, atë fatik, metalinguistik dhe funksionin poetik. E përbashkët për të gjitha këto modele është bindja se sistemi gjuhësor ndërtohet në bazë të përdorimit të gjuhës, bindje kjo që vuri bazat e analizës kritike të diskursit. Modeli funksional i përshkruar të gjuhës, që hulumton ndërlidhjen mes strukturave gjuhësore në tekst dhe vlerave shoqërore që ngërthejnë ato, shfaqet në disa studime të albanologjisë. Më 1980, R. Ismajli (“Shumësia e tekstit”) analizon tekste të shkruarëve rilindas shqiptarë, për të hetuar elementet që dalin nga analiza tejfrazore e foljeve, për të vënë në pah shumëfishësinë e funksionit të morfemave foljore si koha, aspekti, mënyra dhe diateza. Po ai ka bërë studimin stilistik të tekstit të Kuvendit të Arbërit (“Gjuha shqipe e Kuvendit të Arbërit”, 1985), duke e nxjerrë në sipërfaqe ideologjinë e tekstit dhe shfrytëzimin retorik të mekanizmave gjuhësorë. Lindita Aliu-Tahiri e shfrytëzoi modelin sistemik-funksional për të bërë analizën gjuhësore të veprës të Kadaresë në punimin e saj të magistraturës (1985) një pjesë e së cilës u botua në vitin 2009 (“Rrëfimi impersonal i Kadaresë”). Përmes modelit të Hallidejit, Aliu-Tahiri e trajtoi teknikën e monologut të brendshëm në letërsinë shqipe në librin “Monologu, personazhi dhe autori” (2006), duke e ndërlidhur përshkrimin e përdorimit sasior të elementeve të caktuara gjuhësore me domethënien e këtij përdorimi brenda kontekstit ligjërimit të veprës, e sidomos gjatë artikulimit të botës së brendshme të personazhit. Në përmbledhjen e punimeve “Gjuha dhe lufta e ideve” (2013) po kjo autore analizon gjuhën e letërsisë dhe diskursit medial përmes modelit funksional dhe analizës kritike të diskursit. Studime funksionale viteve të fundit kanë realizuar edhe B. Rugova, Rr. Paçarizi, L. Sejdiu-Rugova, Sh. Munishi etj. (Shpëtim Elezi)

STUDIMET GJINORE. Janë fushë ndërdisiplinare e studimeve, që e rishikojnë gjininë si dimension themelor të jetës personale,

shoqërore dhe politike. Studimet gjinore, kryesisht si fushë sociologjike e studimit, për herë të parë u bënë pjesë e programit mësimor si lëndë e veçantë në Universitetin e Prishtinës, në departamentin e sociologjisë, me kalimin e sistemit arsimor të paraluftës në sistemin arsimor të Bolonjës, në vitin 2001. Si lëndë obligative filloi të ligjërohet më 2005. Përmes këtyre studimeve synohet zbardhja e raporteve gjinore, studiohen format e organizimit të jetës në martesë, komunikimi ndërgjinor nëpër faza të zhvillimit historik dhe në hapësira të ndryshme sociokulturale. Ky kurs studimor synon hapjen e debateve, prezantimin dhe përkthimin e literaturës bashkëkohore lidhur me analizat e gjinisë si konstrukt biologjik dhe të rolit gjinor si strukturë dhe konstrukt social, përfshirë edhe rrethanat e shoqërisë kosovare. Viteve të fundit ligjërohet si modul, më së shpeshti si kurs zgjedhor edhe në disa departamente të tjera, kryesisht në Fakultetin Filozofik. Programi është kurorëzim i punës profesionale dhe përpjekjeve shumëvjeçare të grave akademike për institucionalizimin e studimeve dhe hulumtimeve gjinore në arsimin e lartë. (Linda Gusia)

STUDIMET PASDIPLOMIKE. Studime superiore për kandidatët që kanë përfunduar studimet në fakultete, akademi etj., me mësim katër apo pesëvjeçar. Studimet pasdiplomike organizohen si studime specializimi, pas të cilit kandidati merr titullin e specialistit ose si studime të magjistraturës, pas së cilës kandidati merr titullin e magjistratit. Nga viti 2000 studimet e larta në Kosovë organizohen sipas modelit evropian të studimeve, me tri nivele: baçelor (BA), master (MA) dhe doktoratë (PhD). (Naser Zabeli)

STUDIMET SOCIOLINGUISTIKE TË SHQIPES. Janë vazhdimësi e studimeve të tjera të karakterit lingvistik që janë kryer në fushën e gjuhësisë shqiptare në shek. XX. Sociolinguistika ka shënuar të arritura të pakta në fushën e gjuhësisë shqiptare. Studimet kryesore sociolinguistike janë kryer në fushën e planifikimit të shqipes dhe të politikës gjuhësore e, deri diku, janë trajtuar edhe çështjet e ndikimit ideologjik, të variacionit gjuhësor të shqipes, të kontakteve të gjuhës etj. Studimet e para sporadike janë kryer në fillim të viteve '70 të shek. XX. I tillë mund të

konsiderohet studimi i Peter Traxhill (1975) në fushën e kontakteve të gjuhëve lidhur me gjendjen e arvanishtes në Greqi (1990). I po të njëjtës periudhë është edhe studimi i parë i mirëfilltë sociolinguistik në fushën e politikës dhe planifikimit gjuhësor të shqipes i autores amerikane Xhenet Bajron (1976), që trajton rrjedhat e planifikimit të shqipes në Shqipëri dhe ndikimin e faktorëve shoqërorë e ideologjikë të kohës në këtë proces. Një autor tjetër i huaj që është marrë me probleme të arvanishtes është Lukas D. Cicipis, i cili në librin e tij "Antropologjia linguistike e praktikës dhe këmbimit të gjuhës: arvanitika dhe greqishtja në kontakt" ("A Linguistic Anthropology of Praxis and Language Shift: Arvanitika and Greek in Contact") trajton gjendjen e arvanishtes në Greqi. Rexhep Ismajli botoi një sërë studimesh sociolinguistike për botën shqiptare. Nga këndvështrimi sociolinguistik ai u mor me trajtimin e çështjeve të planifikimit gjuhësor dhe të shqipes standarde. Një autore tjetër është Mariana Ymeri, e cila është marrë me qëndrimet e studentëve lidhur me raportet gjuhë standarde/dialekt, me çështjet e ekonomizimit gjuhësor në kuadrin e planifikimit të gjuhës (1994), si dhe tiparet e ligjërimit të folur në chat (2005). Kontribut i Ymerit është edhe përkthimi i librit të R. A. Hadsonit, "Sociolinguistika" (2002). Më 1996 një tjetër tekst ka botuar Gjovalin Shkurtaç. Aspektit teorik të planifikimit gjuhësor i është qasur edhe Rahmi Memushaj. Çështjet e politikës gjuhësore dhe të planifikimit të shqipes në Shqipëri janë trajtuar edhe nga Bahri Beci në një sërë punimesh të viteve '90 të shek. XX, të përmbledhura në "Probleme të politikës gjuhësore dhe të planifikimit gjuhësor në Shqipëri" (2003). Ndikimi ideologjik në standardizimin e shqipes është përshkruar nga Ardian Vehbiu: "Fraktalet e shqipes, rrëgjimi i gjeometrive të standardit" (2007) dhe "Shqipja totalitare, tipare të ligjërimit publik në Shqipërinë e viteve 1945-1990" (2009). Pas vitit 2002 kemi një varg punimesh të botuara kryesisht në Kosovë. Eda Derhemi ka trajtuar çështjen e rrezikshmërisë së arbërishtes dhe dukuri të caktuara të lidhura me të. Në Seminarin Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare është krijuar një qerthull i studimeve sociolinguistike në Prishtinë. Shkumbin Munishi me një sërë

studimesh është marrë me çështje të politikës dhe planifikimit gjuhësor, të variacionit gjuhësor, të barazisë së gjuhëve e të ideologjisë gjuhësore, me ndikimin e internetit në shqipe, me dygjuhësinë etj. Rahman Paçarizi gjithashtu ka trajtuar problemin e planifikimit gjuhësor të shqipes nga aspekti psikosociolinguistik, dukurinë e komunikimit përmes mesenxherit, si dhe rrezikshmërinë e gjuhës shqipe. Bardh Rugova ka analizuar diskursin e medieve, dukurinë e dizajnit të audiencës dhe çështjen e statusit të gjuhëve. Autorë të tjerë janë L. Tahiri, F. Rustemi, L. Shamku-Shkreli, A. Doka, M. Hysa e O. Baja, J. M. Kolgjini, M. Bregasi etj. Të tilla janë edhe studimet në fushën e kontakteve të gjuhës të V. Nuhiut, B. Mustafës, H. Shabanit etj. Në një publikim të veçantë, nr. 178, të revistës “International Journal of the Sociology of Language”, e drejtuar nga J. A. Fishman, me titull: Studimet sociolinguistike në gjuhën shqipe” (Sociolinguistic Studies on the Albanian language, 2006), redaktuar nga E. Derhemi e P. Pani, janë të përfshirë punime të Gj. Shkurtajt, B. Becit, E. P. Hempit, E. Derhemit, P. Panit, B. Schaderit, Xh. Lloshit, J. Thomajt, R. Memushajt dhe V. Fidlerit. (Imri Badallaj)

STUDIMET TEKSTORE TË SHQIPES. Studime gjuhësore që përfshijnë njësi më të mëdha se fjalia. Në gjuhën shqipe këto studime kanë nisur relativisht herët, në fillim të viteve '70 të shek. XX, duke mos ngecur shumë prapa studimeve që po nisnin në botë. R. Ismajli vazhdon të trajtojë çështje që shkojnë përtej fjalisë, përfshirë qëndrimin folës dhe këndvështrimin të kohët e foljeve. Në punimet e tij të hershme, Ismajli përqendrohet te studimi i teksteve letrare, duke shfrytëzuar studimet e ligjërimit. Te “Shumësia e tekstit” e vitit 1977, Ismajli u referohet analizave teorike të E. Benvenistit e të H. Uajnrhut sipas qëndrimit të folësit, perspektivës folëse dhe reliefizimit të tekstit. Një studiues tjetër, T. Kelmendi, trajton kohët e foljeve duke u zgjeruar përtej koncepteve të fjalisë. L. Tahiri shfaqet me “Rrëfimin impersonal të Kadaresë”, duke trajtuar në mënyrë kuantitative njësitë gjuhësore në kuadër të tekstit, për t'u ndalur më shumë te kohët e foljeve dhe këndvështrimi folës. Viteve të fundit, studimi i njëjësive të tekstit është përhapur edhe më, ndërsa pas viteve nëntëdhjetë dhe rënies së sistemit monist edhe

në Shqipëri ka nisur interesimi për studimin e njëjësive gjuhësore që shkojnë përtej fjalisë. Në Maqedoni, A. Çeliku botoi monografinë për koherencën tekstore, ndërsa në Shqipëri, L. Mëniku botoi monografi për konektorët e tekstit. Në Shqipëri, në fund të viteve '90 dhe në fillim të mileniumit të ri, u botuan disa tekste universitare dhe punime të tjera shkencore nga kjo fushë e studimit të gjuhës, ku përvojat e studimeve në gjuhët europiane janë bartur në studimin e tekstit në shqipen. Në Kosovë ka pasur në vitet e fundit punime doktorate, masteri dhe artikuj që trajtojnë probleme të ndryshme të shqipes kundruar në rrafshin e përtejfrazës, kryesisht në rrafshin e kohëve të foljeve e të klasifikimit të mbiemrave. B. Rugova më 2009 botoi monografinë “Gjuha e gazetave” që bën përshkrim tekstor të teksteve të gazetave, ndërsa më 2015 është botuar “Hyrje në gramatikën e tekstit të gjuhës shqipe” nga B. Rugova dhe L. Sejdiu-Rugova. (Imri Badallaj)

STUDIMI I FIZIBILITETIT I KOMISIONIT EUROPIAN PËR KOSOVËN (2012-2013).

Dokument i Komisionit Europian për vlerësimin e gatishmërisë së Kosovës për të hyrë në procesin e stabilizim-asocimit. Ky hap fillestar për përfshirjen e Kosovës në procesin e integritimit në BE u realizua pas kërkesave të autoriteteve kosovare dhe insistimit të një numri shtetesh anëtare të BE-së, të cilat e kanë njohur pavarësinë e Kosovës. Gjatë takimit të Këshillit të Bashkimit Europian në shkurt të vitit 2012, u mor parasysh mendimi i Komisionit Europian për fillimin e Studimit të Fizibilitetit për Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit (MSA) ndërmjet Bashkimit Europian dhe Republikës së Kosovës. Kjo u pasua me pyetësorin prej 444 pyetjesh nga ana e Komisionit Europian, që iu dorëzua institucioneve të Kosovës. Gjatë muajve maj-qershor 2012 autoritetet e Kosovës, me rol bashkërendues të Ministrisë së Integritimit Europian, përgatitën përgjigjet në pyetësor dhe i dorëzuan ato të përmbledhura në 1,942 faqe. Në fund të qershorit 2012 në Kosovë qëndroi misioni faktmbledhës i BE-së, ndërsa në gusht 2012 Qeveria e Kosovës dorëzoi kontributin përfundimtar për Studimin e Fizibilitetit, i cili është miratuar nga Komisioni Europian në tetor të vitit 2012, ku ishte matur gatishmëria e Kosovës për të filluar negociatat për MSA-në. Studimi i Fizibilitetit konfirmon se nuk ka pengesa ligjore për të nënshkruar

MSA-në ndërmjet Kosovës dhe BE-së, ndërsa si bazë ligjore përdorej neni 218 i Traktatit për Funkcionimin e BE-së. Studimi nxjerr përfundimin për mundësinë e BE-së të lidhë marrëveshje, të cilat nuk kufizohen në shtete të pavarura dhe organizata ndërkombëtare. Nisur nga mungesa e unitetit brenda BE-së rreth statusit të Kosovës, në studim sqarohet se negociimi dhe nënshkrimi i MSA-së nuk paraqet njohje të Kosovës nga shtetet që nuk e kanë bërë këtë, me kusht që një rezervë e këtillë të përmendet shprehimisht. Njëkohësisht, sqarohet se negociimi dhe nënshkrimi i MSA-së nuk paraqet as zhbërje të njohjes nga shtetet anëtare, të cilat e njohin pavarësinë e Kosovës. Në studim analizohen aspektet politike si dhe aspektet ekonomike të funksionimit të Kosovës. Studimi, krahas vlerësimit të përgjithshëm pozitiv të kapaciteteve të Kosovës për të negociuar dhe zbatuar MSA-në, përcaktohen edhe kushtet afatshkurtra, të cilat duhen përmbushur nga institucionet e Kosovës, para fillimit të negociatave. Masat e identifikuar nga Komisioni Europian si kushte për fillim të negociatave për MSA-në kanë të bëjnë me sundim të ligjit, reforma të administratës publike, mbrojtje të trashëgimisë kulturore dhe tregti. Në studim po ashtu janë vlerësuar kapacitetet e Kosovës për të implementuar MSA-në. (Iilir Dugolli)

SUHAREKA (THERANDA). Qytet në Rrafshin e Dukagjinit, qendër e komunës me të njëjtin emër. Ndodhet 17 km në verilindje të Prizrenit dhe 43 km në jugperëndim të Prishtinës,



SUHAREKA

lartësia mbidetare 396 m. Është e vendosur në rrugën magjistrale Prizren-Prishtinë. Në rrethinën e Suharekës (Hisar, Dubiçak, Shirokë)

janë gjetur gjurmë që tregojnë për zhvillimin e vendbanimit që nga parahistoria (shek. VIII-VII p.e.s). Gjurmët arkeologjike dëshmojnë se banorët e këtyre lokaliteteve mbanin lidhje tregtare me lokalitete tjera në detin Adriatik. Për herë të parë përmendet në vitin 1348. Udhëpërshkruesi i njohur Ami Boue, duke kaluar nëpër këtë vendbanim në vitin 1836 shkruan se ka vërejtur vetëm banorë shqiptarë. Në kohën e Perandorisë Osmane, Suhareka ka luajtur rol në jetën shoqërore për banorët e zonës rrëzë maleve dhe pranë Drinit. Ishte seli e bajrakut që kishte 42 vendbanime. Bajraku është kujdesur edhe për rrugën Shkodër-Kosovë. Në vitin 1921 kishte 945 banorë. Mes dy luftërave botërore u sollën kolonë serbë. Në vitin 1928 shpallet qytezë, kur filloi të rritet edhe numri i shërbimeve. Në vitin 1948 kishte 1,715 banorë, kurse në vitin 1991 kishte 10,497 banorë. Pas Luftës së Dytë Botërore qyteti pësoi ndryshime në strukturën ekonomike dhe morfologjike, me ç'rast mori tipare të qendrës urbane. Në zhvillimin e vendbanimit rol të rëndësishëm ka luajtur pozita e mirë në raport me lidhjet komunikuese, afirmimi ekonomik, sidomos pas viteve '60, kur merr funksionet e qendrës komunale. Në fillim të viteve '70 u ndërtua fabrika e gomës "Ballkan", e cila punësonte deri 1,800 punëtorë dhe u afirmua në tregun e brendshëm dhe të jashtëm me produktet e gomës, kryesisht rripa trapez dhe shirita transportues. Në anë tjetër, Suhareka kishte sipërfaqe të mëdha të mbjellë me vreshta dhe pemë, gjë që ndikoi në zhvillimin e industrisë ushqimore. Gjithashtu tokat bujqësore rreth lumit Toplluha ndikuan që një pjesë e popullsisë të merret me bujqësi. Në qytet zhvillohet shkollimi fillor dhe i mesëm (gjimnazi, shkolla profesionale), ekziston qendra e mjekësisë familjare, shërbimi i gjeodezisë, radio lokale, qendra të ndryshme tregtare dhe objekte të tjera afariste. Në regjistrimin e vitit 2011, në vendbanim ishin të pranishëm 10,442 banorë. (Valbon Bytyçi)

SUHAREKA (THERANDA) (komuna). Njësi komunale në Rrafshin e Dukagjinit. Shtrihet në pjesën juglindore të Rrafshit të Dukagjinit, në pjesën veriore të maleve të Sharrit, një pjesë të maleve të Jezercës dhe maleve të Carralevës. Sipërfaqja e komunës është 361 km². Komuna e Suharekës ka pozitë të përshtatshme gjeografike. Nëpër territorin e saj kalonin rrugë të

rëndësishme, të cilat lidhnin bregdetin e Adriatikut me pjesën qendrore të Gadishullit Ballkanik. Sot, nëpër komunën e Suharekës kalon rruga Prizren-Prishtinë (magjistralja dhe autostrada). Pjesa lindore e komunës së Suharekës karakterizohet me ndërtim të vjetër gjeologjik, të përfaqësuar nga rreshtet sericitike, filite etj. Në jug, në Malet e Sharrit, hasen shkëmbinj të llojlojshëm, ultrabazikët, gëlqerorët etj. Në veri hasen shkëmbinj të gëlqerorë, kurse pjesa fushore (perëndim) ndërtohet nga depozitime të reja (rërë, zhavorre, argjilë, depozitime liqenore etj.). Në pjesën jugore, territori i komunës depërton në malet e Sharrit (Pashallarë, 2092 m), kurse në lindje dhe veri hasen terrene kodrinore (malet e Jezercit, Carralevës, Milanovcit). Pjesa perëndimore karakterizohet me terren të rrafshët (34% e komunës) që i takon Rrafshit të Dukagjinit. Afërsia me luginën e Drinit të Bardhë ka bërë që pjesa fushore e komunës të ketë klimë kontinentale me ndikime të klimës mesdhetare. Në pjesën fushore, temperatura mesatare vjetore është 10°C, kurse në viset e larta malore ulet deri në 5°C. Sasia e reshjeve sillet në 700-1100 mm. Në territorin e komunës hasen burime të llojeve të ndryshme, gurra dhe burimet e tipit të çarshmërisë në pjesën lindore (Budakovë, Çadraq etj.). Pjesa e ulët fushore është e pasur me ujëra nëntokësore. Rrjeti lumor përbëhet nga Toplluha me degët e saj, e cila bashkohet me Drinin e Bardhë. Pjesa tjetër i takon lumit Mirusha, Carraleva etj. Hasen lloje të ndryshme të tokave. Pjesa fushore dallohet me toka të bonitetit të lartë: aluvionale, smonica, të mesme të kuqërremta, të cilat kanë luajtur rol të rëndësishëm në zhvillimin e bujqësisë. Derisa në pjesën fushore kati i dushkut është zëvendësuar me atë të kultivuar, në zonat kodrinore-malore haset kati i ahut dhe i halorëve, kurse në lartësitë më të mëdha kullotat malore. Me pyje janë të mbuluar rreth 40% e sipërfaqes.

Në komunën e Suharekës janë gjetur gjurmë të vjetra arkeologjike që dëshmojnë se kjo pjesë ishte e banuar shumë herët, që nga koha e neolitit. Gjatë shekullit XX në vendbanimet e kësaj komune u vendosën shumë kolonë serbë e malazezë. Në regjistrimin e popullsisë të vitit 1948, në komunën e Suharekës u regjistruan 22,893 banorë, kurse në vlerësimin e vitit 1991 komuna kishte 64,530. Me regjistrimin e popullsisë së vitit 2011, të pranishëm ishin 59,722 banorë. Rreth 82% e popullsisë jeton

në fshatra, kurse 18% në qytet. Komuna e Suharekës është e organizuar në 41 njësi kadastrale, qyteti dhe 40 vendbanime rurale. Pas Luftës së Dytë Botërore pjesa më e madhe e popullsisë merrej me bujqësi e blegtori. Ndryshimet më të mëdha ekonomike filluan në vitet 1970, me ndërtimin fabrikës së gomës "Ballkan" dhe të disa kapaciteteve të tjera prodhuese e shërbyese. Sot komuna e Suharekës synon zhvillimin ekonomik përmes bujqësisë intensive, industrisë së gomës dhe kimike, të pijeve, pylltarisë, turizmit etj. (Valbon Bytyçi)

SUKA E CËRMNIANIT. Kodër me lartësi maksimale 699 m, e cila ngrihet mbi terrenin e ulët rrethues, ndërmjet fshatrave Cërmnian dhe Gërgoc, në verilindje të Gjakovës. Suka e Cërmnianit ka formë të zgjatur, në drejtimin verilindje-jugperëndim dhe është e ndërtuar nga shkëmbinj kuarckeratofirë dhe kuarçporfirë. Është e mbuluar me vegjetacion. Në majën e Sukës së Cërmnianit ekzistojnë rrënojat e mureve, që tregojnë se këtu dikur ka ekzistuar një kala dhe një vendbanim i vjetër. Suka e Cërmnianit, me Sukën e Radoniqit e të Hereqit në perëndim, në aspektin morfologjik e ndan fushën e Pejës, respektivisht të Baranit, nga fusha e Gjakovës. Në afërsi të Sukës së Cërmnianit gjendet liqeni artificial i Radoniqit, nga i cili furnizohet me ujë të pijes Gjakova dhe Rahoveci me fshatrat përreth. (Vahdet Pruthi)

SULEJMANI Berton (1977-). Gjuhëtar, profesor universiteti. Lindi në Shkup. Aty kreu shkollimin fillor dhe gjimnazin. Studioi për gjuhë dhe letërsi shqiptare në Universitetin e Shkupit (1999). Më pas kreu studimet pa-suniversitare dhe mbrojti tezën e disertacionit të doktoratës për kongruencën e gjymtyrëve kryesore të fjalisë në gjuhën shqipe dhe në maqedonishte. Punoi në gjimnazin "Zef Lush Marku" të Shkupit. Nga 2008 punon në katedrën e gjuhës dhe të letërsisë shqiptare në Universitetin e Tetovës, docent për lëndët sintaksë e histori e gjuhës shqipe. Ka marrë pjesë në hartimin e planeve dhe të programeve mësimore të gjuhës shqipe për ciklin universitar në Maqedoni, në projekte hulumtuese, profesionale vendore e rajonale, si dhe në konferenca për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare. Botoi artikuj kryesisht me trajtim preskriptiv dhe monografinë "Gjuha standarde shqipe dhe shkolla, zotërimi i saj nga nxënësit e shkollave

të mesme të Shkupit” (2011). Botoi veprën me bashkautorë “Doracak për mësimin e gjuhës joamtare”. (Haki Hysenaj)

SULEJMANI Fatmir (1959-). Shkrimtar, studiues, mësimdhënës universitar. Lindi në Tetovë. Kreu shkollën fillore dhe të mesme në vendlindje. Mbaroi Akademinë Pedagogjike për gjuhë e



FATMIR
SULEJMANI

letërsi shqipe dhe gjuhë dhe letërsi maqedonase në Shkup. Më vonë u diplomua në degën e gjuhës dhe të letërsisë shqipe në Universitetin e Shkupit. Në Universitetin e Tetovës mbrojti magjistraturën, ndërsa në Qendrën e Studimeve Alba-

nologjike në Tiranë mbrojti tezën e disertacionit të doktoratës për veprën letrare të Luan Starovës. Ishte mësimdhënës në disa shkolla fillore, këshilltar i pavarur pedagogjik dhe së fundi mësimdhënës i letërsisë shqipe në Universitetin e Tetovës dhe në Universitetin e Europës Juglindore po në Tetovë. Është drejtues i revistave dhe botimeve “Brezi 9”, “Tribuna-Sh” dhe autor i disa vëllimeve me shkrime eseistike, poezi satirike, ese, monografi etj. Mori pjesë në shumë konferenca shkencore, tryeza, debate. Midis tjerash botoi dhe këta libra: “Hamami i kasabasë Tum-batun” (1994), “Gjahu i qorrave” (2000), “Muzgu i mendjes” (2002), “Dr. Jusuf Rexhepi” (2006), “Faik Konica-eseist” (2011), “Lëkura e derri” (2012), “Saga ballkanike e Luan Starovës-një lexim hermeneutik” (2013) etj. (Eqrem Basha)

SULEJMANI Hivzi (1912-1975). Romancier, tregimtar, dramaturg. Lindi në Mitrovicë, ku e kreu shkollimin fillor. Kreu Medresenë e Madhe në Shkup në vitin 1933. Në Beograd studioi për elektromakinë dhe u përfshi në



HIVZI SULEJMANI

lëvizjen përparimtare studentore para Luftës së Dytë Botërore. Ishte pjesëmarrës i Luftës Nacionalçlirimtare. Pas luftës ushtroi disa funksione të rëndësishme në pushtetin e ri. Tregimet e para, në gjuhën serbe, i botoi para lufte në gazetat e atëhershme “Venac”, “Almanah

mladih” etj. Pas lufte tërë krijimtarinë letrare e botoi në gjuhën shqipe, kryesisht te revistat letrare “Jeta e re”, “Përparimi”, “Zani i rinisë” etj. Botoi këto vepra: “Era dhe kolona” (tregime, 1959), “Andrra e korbit” (1968), “Miu në xhep” (komedi, 1958); dhe romanet: “Njerëzit” (1966), “Fëmijët e lumit tim” (1969) dhe “Fluturat në shi” (1969). Është autor i romanit të parë shqip në Kosovë. Në tërësinë e veprës së tij mbizotëron vizioni i autorit drejt profilit etik të njeriut dhe shoqërisë, sidomos në kontekstin e kthesave historike të rëndësishme, siç ishte Lufta Nacionalçlirimtare. Në dy vëllimet e romanit “Njerëzit”, por edhe te romani “Fëmijët e lumit tim”, H. Sulejmani sjell tipin e prozës autobiografike. Kryepersonazhi te romani i parë me emrin Hafiz është edhe substitui i emrit Hivzi. Lënda fabulare e tyre mbështetet në momente, përjetime të rëndësishme nga jeta e autorit. Fjala është për situata që autorin e vënë përballë sfidave kryesisht morale. Përmes ballafaqimeve të kësaj natyre, H. Sulejmani thauja në tërë veprën e vet letrare është në kërkim të njeriut me virtyte, të njeriut dhe shoqërisë së moralshme. Ngjarjet e kohës dhe të hapësirës nëpër të cilën ecën personazhi-vetë autori, kanë vënë në sprovë të forta kodet etike, çfarë ka qenë edhe shqetësimi krijues i tij. I tillë, por novator për nga poetika narrative, ka qenë edhe në prozën tregimtare. Një pjesë e tregimeve të tij kanë premisa moderne dhe si të tilla tingëllojnë edhe sot. Shquhet sidomos për guximin intelektual, kur trajton raportin e individit përballë shtetit dhe me shtetin, shpesh duke i sjellë në pozita përplasëse. Edhe me këtë rast modeli pozitiv i personazhit përputhet me linjën biografike të vetë shkrimtarit. I popullarizuar ishte emri i H. Sulejmanit edhe si autor tekstesh skenike, sidomos me veprën nga gjinia e dramës me komedinë “Miu në xhep” me prani jetëgjatë në teatrin e Prishtinës, por edhe në të gjitha skenat teatrore shqiptare të kohës. (Ali Aliu)

SULEJMANI Sejfedin (1938-2008). Filozof, kritik letrar, mësimdhënës universiteti. Lindi në Burim të Kumanovës, ku kreu shkollën fillore, ndërsa të mesmen e kreu në Shkup. Më 1960 filloi studimet dyvjeçare për filozofi në Universitetin e Shkupit, më pas punoi mësimdhënës në gjimnazin e Kumanovës. Në vitin 1973 doktoroi në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Një kohë punoi si gazetar dhe më vonë kryeredaktor i gazetës

“Flaka e vëllaznimit”. Nga viti 1975-2002 ishte mësimdhënës universitar në departamentin e filozofisë të Universitetit të Shkupit. Gjatë kësaj periudhe u angazhua në mbështetje të politikave maqedonase për diskriminimin e shqiptarëve. Botoi shumë punime publicistike dhe trajtesa të ndryshme, përfshirë edhe disa vepra nga fusha e filozofisë: “Çështje estetika” (1971), “Filozofia e arti” (1971), “Dialektika e mendimit filozofik” (1974), “Skicë e historisë së filozofisë” (1976), “Estetika” (1981), “Historia e filozofisë” (1994) etj. (Albulena Alushaj)

SULI Astrit (1976-1999). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), dëshmor. Lindi në fshatin Luzaj të Beratit. Pasi kreu shkollën e mesme emigroi në Greqi. U kthye nga Greqia dhe u bashkua me vullnetarët në Burrel, të cilët stërviteshin për luftë në Kosovë. Në maj të vitit 1999 hyri në përbërjen e një batalioni që u vendos në lartësitë e fshatit Gorozhup, në faqen e malit të Pashtrikut, në përbërje të forcave që do të realizonin Operacionin “Shigjeta”. Më 26 maj 1999 filloi sulmi i forcave të UÇK-së në sektorin e Gorozhupit, ku gjendej edhe togu i A. Sulit. Më 27 maj forcat e UÇK-së u sulmuan me artileri nga forcat armike. Në muzgun e asaj dite, njësitë e UÇK-së kaluan në kundërsulm, por në atë sulm u vra A. Suli dhe pesë dëshmorë të tjerë. Në vitin 2000 trupi i A. Sulit u rivarros në Varrezat e Dëshmorëve të Qytetit të Beratit. (Dilaver Goxhaj)

SULMET BARBARE. Sulme të fiseve dhe të popujve të tjerë kundër kufijve kryesisht veriorë të Perandorisë Romake. U quajtën “sulme barbare”, nga që të gjithë popujt që jetonin jashtë kufijve të Perandorisë romakët i konsideronin barbarë. Sulmet filluan nga shek. IV dhe zgjatën deri në fund të shek. VII. Këto sulme merren si njëri ndër shkaqet kryesore të shkatërrimit të Perandorisë Romake. Ndër popujt më të njohur që lidhen me sulmet barbare ishin gotët, hunët, avarët, sllavët etj. Gotët kaluan Danubin e Poshtëm e brigjet e Detit të Zi në shek. III, duke sulmuar e shkatërruar një pjesë të Ballkanit dhe të Anadollisë. Gjatë sundimit të mbretit Berig të shek. IV morën Dakinë. Gotët ishin të ndarë nga lumenjtë Dniestër dhe Odër në dy grupe kryesore, Thervingët (udhëhequr nga dinastia Balti) dhe Greuthungët (udhëhequr nga dinastia Amali).

Në vitin 408, prijësi i gotëve Alariku nisi fushatën në Itali dhe u tërhoq nga Ballkani. Krizën dhe sulmet e pareshtura të fiseve “barbare” të shek. IV e ilustron Shën Hieronimi në formë përmbledhëse, kur thotë: “Kudo zi, kudo ofshe dhe hija e madhe e vdekjes”. Pas rënies së hunëve dhe pas Betejës së Nedaos (453), sulme pati edhe nga ostrogotët, të cilët nën Theodorikun e Madh u transferuan në Mezi (rreth viteve 475-488) dhe në vitin 479 e goditën edhe provincën e Epirit. Fiset e hunëve, me origjinë nga stepet euroaziatike dhe të udhëhequr nga Atila, e sulmuan dhe e plaçkitën edhe Dardaninë në shek. V. Shumë nga popujt barbarë u tërhoqën pas ekspeditave të vazhdueshme plaçkitëse. Ndër të fundit ishin avarët, të cilët kishin krijuar dhe mbretëri rreth liqenit Ballaton (Hungari: Kaganati I, II). Pas ekspeditave plaçkitëse të avarëve lëviznin më këmbë fiset sllave, të cilat u vendosën në territoret e dikurshme të Ilirikut dhe më gjerë. (Arben Arifi)

SULLTAN MEHMETI II (1432-1481). Renditet në mesin e sulltanëve më të rëndësishëm të dinastisë osmane. Ky sulltan e pushtoi Konstandinopojën (1453) dhe e bëri kryeqytet të Perandorisë. Epitetin “Fatih” (Nga-dhënjimtar) e mori pas pushtimit të Stambollit. Njihet si sulltan i ardhur në fron dy herë me radhë. Herën e parë (1444-1446) erdhi në fron si rezultat i abdikimit të babait të tij (sulltan Muratit II), i cili bënte jetë askete në rrethinën e Bursës. Mirëpo kjo tërheqje shkaktoi shumë probleme, si në zonat e reja të pushtimit, ashtu edhe brenda shtetit. Në këtë periudhë njihet kryengritja e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut dhe po ashtu kryengritja e Gjin Zenebishit. Ndërkohë, vazhdoi konkurrenca për ndikim në politikën e brendshme të shtetit nga familja e Çandarëve me në krye Halil Pashën (udhëheqës me ndikim të jeniçerët), përkrahës i sulltanit të mëhershëm (Muratit II) kundrejt Shahabetin Shahin Pashës dhe Zognos Pashës, si përkrahës të sulltanit të ri. Problemet e mëdha në sundim, kryengritjet dhe luftërat e shumta e detyruan sulltanin e ri të tërhiqet nga fronti për t’ia lënë fronin sërish babait të tij, sulltan Muratit II. Përpjekjet për të shtrirë sundimin e shtetit osman në Shqipëri u penguan nga Gjergj Kastrioti edhe gjatë udhëheqjes së dytë të sulltan Mehmetit II (1451-1481). Udhëhoqi një pjesë të madhe të ushtrisë osmane edhe përballë Janosh

Huniadit në Betejën e Dytë të Kosovës më 1448. Mendohet se ceremonia e bujshme e martesës së tij në Edirne ishte mbulesë e humbjeve të shkaktuara nga Skënderbeu në Shqipëri. Marrëveshjen për armëpushim me Skënderbeun (1462) e prishi personalisht, duke ndërmarrë ekspedita të reja, të cilat sërish rezultuan me humbje. Gjatë këtyre viteve kujdes të veçantë i kushtoi vendosjes së sundimit në pjesët e tjera të Ballkanit, kryesisht në qytetet xehtarë të Kosovës. Sulltan Mehmetit II i takojnë meritat për ngritjen e sistemit perandorak në kuadër të shtetit osman. Tregoi interesim të madh për artin, kulturën dhe filozofinë. Shkroi poezi nën pseudonimin “Avni”. Letrarët, historianët dhe artistët bashkëkohës e përmendin edhe si admirues të krijimtarisë, kulturës dhe artit perëndimor. (Kushtrim Shehu)

SULLTAN MURATI I (1326-1389). Sulltan i Perandorisë Osmane nga viti 1359. Ishte i biri i Orhanit I dhe i princeshës bizantine Helena. U shqua si prijës i parë i dinastisë osmane, që i kushtoi rëndësi të veçantë pushtimit të Ballkanit. Shumë vjet para inaugurimit në postin e sulltanit, mori pjesë në luftime përkrah udhëheqësve të famshëm të ushtrisë osmane në Ballkan, Evrenoz Beut, haxhi Ilijas Beut etj. Në vitin 1362 pushtoi Edrenenë, të cilën e bëri kryeqytet të perandorisë. Shumë dinastë lokale të Bullgarisë, Greqisë, Shqipërisë e Rashës u detyruan ta pranonin vasalitetin e tij, duke u bërë tatimpagues të shtetit osman. Kronikat osmane dhe perëndimore vërtetojnë se i kishte kushtuar rëndësi të madhe pushtimit të qyteteve të pasura xehtarë të Kosovës. Sukseset e tij në Ballkan janë përcjellë me shqetësim nga monarkitë europiane. Papa Urbani V bëri përpjekje për një organizim të përgjithshëm të të krishterëve kundër sulltan Muratit, por nuk arriti ta realizonte, për shkak të vdekjes së hershme. Pranimi i vasalitetit edhe nga perandori bizantin e forcoi edhe më tej pozitën politike dhe ushtarake të sulltan Muratit dhe të vetë Perandorisë Osmane. Përballja me sundimtarët lokalë të Ballkanit arriti kulmin me fitoren e osmanëve në Betejën e Kosovës (1389), në të cilën sulltani humbi jetën, por ia siguroi shtetit osman dominimin edhe në këtë zonë si urë kaluese për në Hungari dhe më tej në Europë. Me vdekjen e Muratit I, vendin e tij e zuri i biri, sulltan Bajaziti. Në fushëbetejë u

ngrit një tyrbe, në kujtim të sulltanit dëshmor, e cila ekziston edhe sot, ndërsa varri i tij gjendet në Bursa të Turqisë. (Kushtrim Shehu)

SULLTAN SYLEJMANI I (1520-1566). Sulltan osman, në kohën e të cilit Perandoria Osmane arriti pikën më të lartë të ngritjes, si në aspektin politik, ushtarak, ekonomik, territorial, po ashtu edhe në art, letërsi dhe shkencë. Në burimet osmane njihej me emrin “Ligjdhënës”, ndërkaq në burimet perëndimore si i “Madhërishtëm”. Në kohën e sundimit të tij, Perandoria Osmane njohu zgjerimin më të madh territorial. Njihet për përpjekjet e tij për t’u zgjeruar në Europën Qendrore. Pas pushtimit të kështjellave të Beogradit dhe Karlovocit të Sremit (1521), si dhe ishullit Rodos (1522), Sylejmani vazhdoi drejt Hungarisë, e cila në vitin 1526 e pranoi vasalitetin osman. Në këto fushata morën pjesë edhe shumë sanxhakbejerë shqiptarë, të cilët pas pushtimit u caktuan guvernatorë të atyre viseve. Sylejmani e vazhdoi fushatën deri në Vjenë (shtator 1529), por pas rrethimit trejavësh të kryeqytetit Habsburg u detyrua të tërhiqej. Sulltan Sylejmanin e karakterizon edhe fakti se kundërshtarët e tij më të mëdhenj, Papën dhe Habsburgët nuk i luftoi vetëm me armë, por edhe me luftë ideologjike, duke e përkrahur luteranizmin, si dhe duke lidhur aleancë me kundërshtarin e tyre natyror, Francën. Aleanca politike dhe ekonomike me Francën (1536) rezultoi me planin e përbashkët franko-osman për ta pushtuar Italinë. Në kohën e sundimit të Sylejmanit Ligjdhënës u shquan si kurrë më parë një numër i madh shqiptarësh, që mbajtën pozitat më të larta shtetërore. Bashkëkohësit jo rrallë e spikatnin faktin se sulltan Sylejmani ishte i rrethuar me shqiptarë. Në kohën e tij që intensifikuar zhvillimi urban në sanxhaqet shqiptare, të cilat drejtoheshin kryesisht nga sanxhakbejerë vendës. Edhe rregullimi administrativ i sanxhaqeve shqiptare të kohës së Sylejmanit mbeti afërsisht i njëjtë deri në shekullin XIX. Sulltan Sylejmani i kushtoi rëndësi të posaçme edhe dominimit ideologjik dhe shtetëror të osmanëve mbi botën islame, mbi bazën e trashëgimisë së kalifatit. Në fushatën e trembëdhjetë dhe të fundit kundër habsburgëve, në ditën e pushtimit të fortifikatës së Sigetit (shtator 1566) vdiq në moshën 72 vjeçare. (Gazmend Rizaj, Kushtrim Shehu)

SUMA Imzot Mihill (Mikel) (1695-?). Lindi në katundin Baba të Sapës. Në moshën 16-vjeçare u regjistrua në Kolegjin Ilirik në Ferma të Italisë. Më 1718 u shugurua prift në Kishën e “Shën Panteleonit” në vendlindje. Në vitin 1723 ishte misionar në Zadanje të Ipeshkvisë së Sapës. Argjipeshkvi Vinçenc Zmajeviqi e caktoi misionar në Janjevë, ndërsa Papa Benedikti XIII më 1728 e emëroi argjipeshkëv të Shkupit, që atëbotë e kishte selinë në Zym të Hasit. Në vitin 1736, në bashkëpunim me perandorin austriak Karli IV dhe me të krishterët nga mbarë Arbëria, i filloi përgatitjet për luftë kundër turqve. Me këtë angazhim ai i ngriti në kryengritje pjesëtarët e fisit Kelmend, Hot e Grudë. Në këto lëvizje ushtarake rol të rëndësishme patën kelmendasit nga Peshteri, nga Rugova dhe dy familje nga Zymi i Hasit. Me tërheqjen e ushtrisë austriake, pas luftës, bashkë me ta u shpërngulën edhe afro 10,000 shqiptarë të besimit katolikë, të prirë nga imzot Mëhill Suma, prej të cilëve rreth 1,600 veta, përkatësisht afro 300 familje kelmendase kaluan lumin Sava dhe u vendosën në fshatrat Mishkovce, Jurjevce, Keveshince, Baradince, Shapina, që në atë kohë ishin nën sundimin austriak. Në vitin 1755 ata themeluan fshatrat Hërtkovce e Nikince. Imzot Mihill Suma vdiq dhe u varros në Osjek. (Frrok Kristaj)

SUMA LUKA D. PREJ SHKODRE (shek. XVIII). E njohim vetëm në sajë të vjershës në fillim të librit të Bogdanit “Shumë ndriçimit e shumë ndershimit Zotit, Zotit tim, Zot për ndeer, Zotit Pjetër Bogdan, qi kje Upeshkëp i Skodërsë e ronjësi i Tivarit, tash Argjupeshkëpi i Skupsë e ronjësi i regjëniis’ së Sherbiisë”. (Rexhep Ismajli)

SUMA Rexhep (1961-). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Lindi në Rashan të Mitrovicës. Ishte pjesëtar i celulës së parë dhe pjesëmarrës në aksionin e parë të UÇK-së në Burgun e Smrekonicës më 28 shkurt 1998. Ishte njëri ndër themeluesit e njësitit të parë të organizuar në Zabërxhë (prill 1998). Me njësitin e tij elitari mori pjesë pothuajse në të gjitha luftërat në zonën e përgjegjësisë së Brigadës 141, por edhe në ndihmë Brigadës 142 nga 25 shkurti e deri më 17 mars të vitit 1999. Mori pjesë në dhjetëra aksione në Zonën Operative të Shalës, por edhe në Zonën Operative të Llapit (dhjetor 1998).

Ishte pjesëmarrës edhe në luftën 39 ditësh në Melenicë, Majdan e Preten, ku edhe u plagos më 25 prill 1999. (Emin Musa)

SUMA Rufki (1968-). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Lindi në fshatin Dimcë të Hanit të Elezit. Kreu shkollën e mesme në Kaçanik, më pas mbaroi studimet në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës. Me fillimin e pluralizmit politik në Kosovë u përfshi në aktivitetin e Lidhjes Demokratike të Kosovës. Në muajin prill të vitit 1998 iu bashkua UÇK-së në Drenicë. U angazhua me detyrë për furnizimin e UÇK-së me armatim nga Maqedonia. Në qershor të vitit 1998, së bashku me ushtarët e UÇK-së, u vendos në fshatin Puset e Nikës (Pustenik). Në Han të Elezit udhëhoqi njësitin e UÇK-së deri me themelimin e Brigadës 164 “Gafurr Loku”, ku më pas u emërua komandant i kësaj brigade. Pas transformimit të UÇK-së u angazhua në Trupat Mbrojtëse të Kosovës. Më 2009 dhe më 2013, dy herë radhazi, u zgjodh kryetar i komunës së Hanit të Elezit, si kandidat i pavarur. (Ali Uka)

SURROI Flaka (1963-). Gazetare. Lindi në Prishtinë. Kreu shkollimin fillor në Prishtinë, të mesmin në Meksikë dhe studimet në Universitetin e Prishtinës. Në periudhën 1986-



FLAKA SURROI

1991 punoi në BVI-në Krahinore për Punësim, prej nga u largua pas futjes së masave të dhunshme nga Qeveria e Serbisë. Në vitet 1991-1993 punoi vullnetare në kryesinë e Këshillit për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut (KMDLNJ), ndërsa më pas u angazhua në Komisaratin e Lartë të OKB-së për Refugjatë (UNHCR) (1993-1995) e më vonë në Fondin e Emergjencës për Fëmijë të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (UNICEF), ku, ndër të tjera, udhëhoqi edhe ekipin e terrenit gjatë luftës në Kosovë (1995-1999). Në vitin 1999 themeloi dhe udhëhoqi Organizatën joqeveritare “Fondi për zhvillim komunitar”, për rindërtimin e fshatrave të dëmtuar nga lufta. Në vitin 2004 mori drejtimin e Grupit “Koha”, në të cilin, përveç gazetës “Koha ditore” bëjnë pjesë shtypshkronja, TV “Kohavision”, TV “Arta”,

shtëpia botuese “Koha”, portali “Koha.net” etj. Boton rregullisht analiza dhe komente në faqet e gazetës “Koha ditore”. Merret edhe me përkthime. (Artan Krasniqi)

SURROI Rexhai (1929-1988). Shkrimtar, publicist, politikan, diplomat. Lindi në Prizren. Kreu shkollën fillore në vendlindje, ndërsa gjimnazin në Prishtinë. Studimet në shkencat juridike i kreu në Universitetin e Beogradit. Qysh herët u mor me publicistikë. Punoi si redaktor i revistës “Zani i rinisë”, më pas gazetar dhe drejtor i Radio Prishtinës. Ishte ambasador i ish-Jugosllavisë në Bolivi, Meksikë, Honduras, Costa Rika dhe në Spanjë. I takon brezit të parë të shkrimtarëve të Kosovës pas Luftës së Dytë Botërore. Punimet e para letrare i botoi në vitet ’50 në revistën letrare “Jeta e re”. Më 1959 botoi romanin “Besniku”, më pas përmbledhjen me tregime “Dashunija dhe urrejtja” (1961) dhe romanet “Pranvera e tretë” (1971) dhe “Orteku” I, II (1974). Në romanet e tij trajtoi tema sociale dhe të luftës. “Grupi Koha” ndan çmimin vjetor me emrin e tij, për gazetari dhe letërsi. (Isak Shema)

SURROI Veton (1961-). Publicist, politikan. Lindi në Prishtinë, arsimimin bazë e mori në vendlindje, ndërsa studioi në Universitetin Kombëtar Autonom të Meksikos. Me punë filloi



VETON SURROI

në vitin 1982, si gazetar në gazetën “Rilindja”, ndërsa më vonë në sessionin e gjuhës shqipe të BBC-së. Në vitin 1990 filloi botimin e revistës së përjavshme “Koha”, e cila në vitin 1997 u shndërrua në të përditshmen “Koha ditore”, për t’u zgjeruar më pas në aktivitete të tjera mediale dhe botuese, përfshirë TV “Kohavision”, Shtëpinë Botuese “Koha” dhe agjencinë e lajmeve “Arta”, si pjesë të kompanisë “Koha”, të cilën e themeloi dhe udhëhoqi për një kohë. Është laureat i mirënjohjeve të ndryshme, përfshirë i çmimin nga Federata Ndërkombëtare e Gazetarëve (2000), i Medaljes Geunzejgen (2000), i Çmimit për të Drejta të Njeriut të Organizatës për Media në Europën Juglindore (2011) etj. Ishte pjesëmarrës aktiv i një varg nismash për demokraci dhe të drejta të njeriut dhe i përfshirë në proceset për pavarësimin e Kosovës. Ishte

anëtar i delegacionit kosovar në Konferencën e Rambujesë, duke u bërë njëri nga nënshkruesit shqiptarë të kësaj marrëveshjeje. Si njëri ndër pesë anëtarët e Ekipit të Unitetit, mori pjesë në negociatat e Vjenës, të ndërmjetësuar nga ish-presidenti finlandez, Marti Ahtisari, të cilat rezultuan me shpalljen e pavarësisë së Kosovës. Në vitin 2004 themeloi Listën Qytetare “Ora”, parti reformiste e qendrës së majtë, siç u quajt në programin e saj, e cila me shtatë deputetë u përfaqësua në Kuvendin e Kosovës deri në vitin 2007. Pas mosarritjes së pragut zgjedhor për hyrjen në Kuvendin e Kosovës në zgjedhjet parlamentare të vitit 2011, V. Surroi dha dorëheqje dhe njëkohësisht deklaroi tërheqjen nga politika. Është autor i disa librave letrare dhe publicistikë (“Fluturimi i vetëm i Azem Berishës për në Kështjellë”, “Këmbët e gjarprit”, “Miliarderit”, “Ambasadori i Melkizedekut” etj.). (Illir Dugolli)

SUSURI Latif (1941-2016). Agronom, fitopatolog, profesor universiteti, akademik. Lindi në Zhur të Prizrenit, shkollën fillore e kreu në vendlindje, shkollën e mesme bujqësore



LATIF SUSURI

në Prishtinë, ndërsa Fakultetin e Bujqësisë, drejtimin e mbrojtjes së bimëve e përfundoi në Universitetin e Beogradit. Kreu studimet pa-suniversitare nga lënda e fitopatologjisë gjithashtu në Universitetin e Beogradit (1975). Si bur-sist i Fondacionit IREX kreu specializimin njëvjeçar (1976-77) për fitopatologji në SHBA, në Universitetin e Viskonsinit, në Madison. Në vitin 1980 po në këtë Universitet vazhdoi studimet shkencore njëvjeçare. Më pastaj (1996) qëndron në Londër për studime dhe grumbullim të literaturës për tekste universitare dhe punime shkencore. Disertacionin e doktoratës, drejtimi fitopatologji, e mbrojti në Fakultetin e Agronomisë të Universitetit të Zagrebit (1983). Një kohë punoi në Kombinatin “Progres-Export” të Prizrenit, si teknolog për mbrojtjen e bimëve (1967). Më pastaj zgjidhet ligjërues në Fakultetin e Bujqësisë të Universitetit të Prishtinës (1977), duke marrë në vitet vijuese të gjitha gradat universitare. Në vitin 2000 zgjidhet anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës

dhe më 2008 anëtar i rregullt. Në institucionet arsimore dhe shkencore kreu detyra dhe funksione të ndryshme. Është themelues i lëndës së fitopatologjisë në Fakultetin e Bujqësisë. Aktivitetin kryesor e drejton te puna shkencore-hulumtuese në fushën e fitopatologjisë, duke studiuar sëmundjet e bimëve të shkaktuara nga kërpudhat, bakteret, viruset dhe fitoplazmat. Publikoi punime shkencore dhe artikuj të tjerë nga lëmi i ngushtë profesional në vend dhe në botën e jashtme. Botoi librat universitarë “Fitopatologjia” dhe “Fungicidet-herbicidet”. Një fushë e veçantë e angazhimeve të tij është terminologjia bujqësore dhe hartimi i fjalorëve nga kjo fushë, siç janë: “Fjalori i terminologjisë bujqësore (anglisht-shqip, shqip-anglisht)”, pastaj fjalorët shumëgjuhësh për bimë, dëmtes dhe patogjenë, për emrat e bimëve bujqësore, pyjore dhe barojat. Gjithashtu është bashkautor i fjalorit shumëgjuhësh: “Emrat e bimëve”, “Fjalori i termave të botanikës”, “Fjalori shpjegues i termave të botanikës”. L. Susuri ka përkthyer disa patogjenë për herë të parë në botë (*Alternaria alternata*-në bizele), dhe në vend: *Pleospora infectoria*, *Didymella bryoniae*, *Diplocarpon earliana*, *Uromyces striatus*, *Phoma medicaginis*, *Plasmodiophora brassicae*, *Phytophthora capsici*, *Erwinia amylovora*. Për angazhim dhe punë shumëvjeçare në lëmin e shkencës dhe të arsimit të lartë ka marrë çmime dhe mirënjohje. (Feriz Krasniqi)

SUTAJ Ali (1937-1989). Gazetar. Lindi në Llukë të Epërme të Deçanit. Shkollën fillore e kreu në Deçan e Isniq, ndërsa shkollën normale e nisi në Pejë dhe e përfundoi në Prishtinë. Kreu studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Universitetin e Prishtinës. Një kohë punoi mësues në shkollën fillore të Deçanit. Qëkur ishte nxënës në shkollën normale botoi shkrime në revistën “Zëri i rinisë” dhe raportonte nga komuna e Deçanit për gazetën “Rilindja”. Më 1961 u punësua gazetar në “Rilindje”. Përveç lajmeve, raporteve e intervistave, shkroi shumë komente, vështrime, ese dhe analiza nga fusha e politikës dhe letërsisë. Ishte kryeredaktor i “Zërit të rinisë” dhe themelues me detyrë i gazetave “Fjala”, “Kosovarja”, “Shkëndija”, “Thumbi”, “BAT”, “Bota e re”. Një kohë punoi në Komitetin Komunal të LK të Prishtinës, prej nga, pas vitit 1981, u rikthye në “Rilindje”. Është autor i librit me ese “Mbresa” dhe i monografisë “Rilindja 1945-1985”. (Zenun Çelaj)

SUZI Prizrenasi (?-1525). Mësues, poet, historian, kronist. Supozohet të ketë lindur në vitet '50 apo '60 të shek. XV. Emri i tij i plotë ishte Muhamedi i biri i Mahmudit të birit të Abdullahut, nga Prizreni, i njohur në literaturë me emrat dhe pseudonimet poetike, si Suziu, Soziu, Sozi Baba, Suzi Çelebiu, Mevlana Suzi, Suzi Zerrini, Suzi Prizrenasi. Mësimet e para i mori në Prizren, ndërsa studimet i mbaroi në Stamboll. Një pjesë të jetës e kaloi si sekretar personal i akinxhinjve të dalluar të Perandorisë Osmane, Ali bej Mihalogllut dhe Mehmet Beut. Në vitin 1513 e gjejmë të jetë kthyer në Prizren, kur edhe e legalizoi vakëfin e tij. Duke qenë në shërbim të Ali bej Mihalogllut, bëmat e prijësit të tij i përmbloodhi në veprën poetike-historike “Libri i luftërave të Ali beg Mihalogllut”. Shkroi edhe poezi të tjera, si nazire, poezi didaktike-satirike, të cilat atëbotë ishin të popullarizuara. Shkrimet e tij ruhen në Zagreb, Berlin dhe në qendra të tjera europiane. Vëllai i Suziut, Nehari Prizrenasi (vdiq 1522 në Prizren) ishte po ashtu poet i dalluar, sikurse që ishte edhe poeti Saji nga Prizreni, me gjasë edhe ky vëlla i Suziut. Vdiq dhe u varros në tyrben e xhamisë së tij në Prizren. (Irfan Morina)

SVANE Gunar (Gunnar) (1927-2012). Gjuhëtar danez, profesor, sllavist, albanolog. Ishte anëtar i jashtëm i dy akademive shqiptare, të Kosovës dhe të Shqipërisë. Profesor i sllavistikës



GUNAR SVANE

në Universitetin e Aarhusit (Danimarkë) gjatë viteve 1965-1994. Përveç studimeve për sllavishten mesjetare dhe për gjuhët sllave jugore, u ka kushtuar vëmendje të posaçme huazimeve sllave në gjuhën shqipe dhe përfundimet e hulumtimeve të tij i paraqiti edhe në veprën gjermanisht “Huazimet sllave në shqipe” (Slavische Lehnwörter im Albanischen, Aarhus 1992). Studiues, transliterues dhe hartues i konkordancave të veprës së Budit. Botoi studime të veçanta për P. Budin: “Pjetër Budi, Rituale romanum 1621, Konkordanca 1-2” (Pjetër Budi, Rituale romanum 1621, Concordance 1-2, 1982); “Pjetër Budi, Dottrina Christiana 1618 me një tejskrim në drejtshkrimin modern dhe konkordancë” (Pjetër Budi, Dottrina Christiana 1618, with a transcription into modern

orthography and a concordance, 1985); "Dotrina Christiana 1618, Konkordancë 1-2" (Dotrina Christiana 1618, Concordance 1-2, 1985); "Pjetër Budi, Speculum Confessionis 1621, me një tejshkrim në drejtshkrimin modern dhe konkordancë" (Pjetër Budi, Speculum Confessionis 1621, with a transcription in to modern orthography and a concordance, 1986); "Pjetër Budi, Speculum Confessionis 1621, Konkordancë 1-4" (Pjetër Budi, Speculum Confessionis 1621, Concordance 1-4, 1986). (Shpëtim Elezi)

SVASTIKA. Shih: KRYQI I THYER.

SYLA Azem (1951-). Njëri nga themeluesit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), komandant i Shtabit të Përgjithshëm. Lindi në Kishnarekë të komunës së Drenasit. Mbaroi



AZEM SYLA

gjimnazin e shkencave të natyrës në Mitrovicë. Më pas u regjistrua në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore të Universitetit të Prishtinës dhe u diplomua në degën e kimisë. Një kohë punoi si mësimmshënës në Nekoc dhe më pas në gjimnazin e Drenasit dhe të Kijevës. Në vitin 1982, si pjesëtar i lëvizjes ilegale u dënua me 5 vjet burg. Pas daljes nga burgu vazhdoi veprimtarinë në Lëvizjen Popullore të Kosovës (LPK), dega brenda vendit. Ishte anëtar i kryesisë së LPK-së, drejtues i "sektorit të veçantë". Në vitin 1989 u mbajt i izoluar pesë muaj në burgun e Prishtinës. Në vitin 1993, për shkak të përndjekjes së vazhdueshme nga pushteti, kaloi në ilegalitet, duke qëndruar në Kosovë, Maqedoni dhe Shqipëri. Nga viti 1994 e vazhdoi veprimtarinë politike në Zvicër, ku mori strehim politik. Ishte bashkëthemelues i UÇK-së dhe mori pjesë në organizimin dhe pajisjen e saj me armatim që nga njësitet e para. Me riorganizimin e UÇK-së në nëntor të vitit 1988, A. Syla u zgjodh komandant i Shtabit të Përgjithshëm. Në Konferencën e Rambujesë ishte anëtar i delegacionit të UÇK-së. Në Qeverinë e Përkohshme të Kosovës, që nga 1 marsi i vitit 1999 deri në shpërbërjen e saj ishte ministër i Mbrojtjes. Me themelimin e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në vitin 1999, u zgjodh anëtar i Këshillit Drejtues dhe i kryesisë

së PDK-së. Në dy legjislaturat e fundit u zgjodh deputet i Kuvendit të Kosovës. (Ismail Syla)

SYLA Fazli (1935-). Studiues i folklorit. Lindi në Istog. Kreu studimet e larta për gjuhë dhe letërsi shqipe në Shkup (1960), kurse studimet pasuniversitare në Universitetin e Zagrebit (1973). Tezën e disertacionit të doktoratës e mbrojti në Universitetin e Prishtinës më 1979. Punoi fillimisht në gazetari dhe në arsimin e mesëm, kurse nga viti 1978 u zgjodh të ligjëronte për letërsi në Fakultetin e Filologjisë të UP-së. Në vitet 1983-1991 ishte punonjës shkencor në Institutin Albanologjik të Prishtinës, zëvendësdirjtor dhe pastaj drejtor i këtij institucioni gjatë viteve 1986-1991. F. Syla është marrë me studimin e poezisë popullore, kryesisht me këngët epike historike. Nga kjo fushë ka botuar disa vepra: "Poezia popullore shqiptare e kaçakëve" (1982), "Kënga dhe ngjarja historike" (1988), "Çështje të folklorit shqiptar" (1998) etj. Ka dhënë ndihmesë edhe në përgatitjen për botim të materialeve folklorike, të anekdotave, të këngëve kreshnike dhe të këngëve historike, të gjitha të botuara në vëllime të veçanta nga Instituti Albanologjik i Prishtinës. Gjithashtu ka marrë pjesë në hartimin e projekteve afatgjate të zhvillimit të arsimit, të shkencës dhe të kulturës, veçmas gjatë periudhës së autonomisë së Kosovës, kur ishte sekretar krahinor për Kulturë. (Sadri Fetiu)

SYLA Gazmend (1972-). Gazetar. Lindi në fshatin Zasellë të Mitrovicës. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje dhe në Mitrovicë. Studimet i filloi në Fakultetin e Xehetarisë dhe të Metalurgjisë në Mitrovicë dhe më pas studioi për gazetari në Prishtinë, ndërsa pas luftës kreu shkencat politike në Universitetin e Prishtinës. Mbaroi specializimin për gazetari në Universitetin e Oklahomës (SHBA) dhe trajnime e specializime të ndryshme për gazetari. Punën e gazetarit e filloi në gazetën "Kosova sot" (1999), për të vazhduar më pas te gazeta "Koha ditore" (2001), ku qëndroi deri në vitin 2009. Gjatë kësaj kohe mbuloi zhvillimet kryesore politike dhe të sigurisë në Kosovë, ndërsa raportoi edhe nga gjykimi i Sllobodan Millosheviqit në Hagë. Po ashtu raportoi edhe për negociatat për statusin e Kosovës, të zhvilluara në Vjenë (2006-2007). Më pas kaloi te Televizioni "Klan Kosova" (2009), si

kryeredaktor. Ishte edhe kryetar i Asociacionit të Gazetarëve Profesionistë të Kosovës (2007). (Ibrahim Berisha)

SYLA Hamdi (1935-2011). Inxhinier i elektroteknikës, profesor universiteti. Lindi në Oshlan të komunës së Mitrovicës. Shkollimin e kreu në Mitrovicë, studimet për inxhinieri elektrike në



HAMDI SYLA

Universitetin e Zagrebit (1962). Pas mbarimit të studimeve punësohet në ndërmarrjen “Trepça”. Në vitin 1968 vazhdon studimet në Londër (Queen Mary College), në lëmin e përçueshmërisë dhe shpimit të materialeve të lëngëta izoluese. Disertacionin e mbrojti po në Londër. Në vitin 1970 u zgjodh asistent në Fakultetin Teknik, më pas ligjërues dhe profesor inodinar për lëndën bartja dhe shpërndarje e energjisë elektrike. Ishte dekan i Fakultetit Teknik (1977-1979). Në periudhën 1981-1985 qëndroi në Teheran, si drejtor i përfaqësisë së Odës Ekonomike të Jugosllavisë në Iran. Fushat kryesore të studimeve shkencore të H. Sylës kanë qenë zbrazjet në dielektriket e lëngëta dhe efektet e ndikimit të fushës elektrike dhe termike në to, të botuara kryesisht në Britani të Madhe. (Isuf Krasniqi).

SYLA Hamdi (1970-). Mundës. Lindi në Prishtinë. Me mundje filloi në KM “Prishtina”, te trajneri i mirënjohur Muntas Allajbegu. Në moshën 11-vjeçare arriti suksesin e parë duke fituar titullin e kampionit të Kosovës në kategorinë deri në 42 kilogramë. Prej vitit 1981 deri më 1990 doli kampion i Kosovës në konkurrencën e pionierëve, më vonë të juniorëve dhe të seniorëve. Ishte shtatë herë kampion në ish-Jugosllavi (1983-1990); nënkampion i Ballkanit në vitet 1988 dhe 1989. Fitoi medaljen e bronzitë në Kampionatin European në Bursa të Turqisë (1986). Ishte i katërti në Kampionatin Botëror në Francë (1985), si dhe fitues i disa turneve ndërkombëtare në mundje. (Lulzim Shala)

SYLA Hilmi (1950-). Gazetar. Lindi në Zasellë të Mitrovicës. Shkollimin fillor e kreu në vendlindje dhe në Tunelin e Parë, ndërsa të mesmen në Mitrovicë. Kreu studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Universitetin e Prishtinës.

Nisi të punojë si gazetar në gazetën “Rilindja” në vitin 1971, si korrespondent nga Mitrovica. Më pas kaloi në redaksinë e “Rilindjes” në Prishtinë, ku për dy dekada bëri shkrime nga sektori i mbrojtjes dhe i sigurisë. Pastaj, për dy vjet ishte edhe redaktor në rubrikën e brendshme. Pas ndërprerjes së botimit të “Rilindjes” emigroi në Gjermani. (Gazmend Sylja)

SYLA Ismail (1961-). Shkrimtar, publicist. Lindi në Kishnarekë të Drenicës. Mësimet e para i mori në vendlindje, ndërsa shkollimin e mesëm e vazhdoi në Komoran dhe Drenas. Kreu studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës, ku më pas kreu edhe studimet pasuniversitare. Veprat e botuara: “Këngët e lirisë” (1980), “Libri i lirisë” (1991), “Duke kërkuar esencat” (1997), “Tempulli i braktisur” (1998), “Joplotni e lirisë” (2000), “Relieve letrare” (2001), “Religjioni i pikëllimit” (2015). Shkruan poezi, prozë, ese letrare dhe publicistikë. Një kohë të gjatë punoi si gazetar te “Rilindja” (“Bujku”) në Prishtinë dhe bashkëpunoi me revista e gazeta të tjera në shqip. Interesimet e tij përfshijnë letërsinë dhe politikën, ishte dhe është i angazhuar në lëvizje politike e kulturore. Poezia dhe proza e tij njohin për të vetat motivet nacionale, me një ndjeshmëri për detajin, gjuhën dhe stilin. Gjithashtu shkruan kritikën letrare, i përqendruar kryesisht në tipat e heroit letrar. Kohëve të fundit shkruan më shumë publicistikë politike. (Kujtim Rrahmani)

SYLA Jeton (1965-). Gazetar i sportit. Lindi në Gjakovë, ku kreu shkollën fillore dhe të mesme, ndërsa studimet i kreu në Prishtinë. Gjatë viteve ’90 të shekullit të kaluar u mor me organizimin e jetës sportive, sidomos të futbollit. Në vitin 1999 zë punë në Radion “Kosova e Lirë”. Përveç në rubrikat e sportit, u angazhua edhe në redaksitë e tjera, si në ekonomi, politikë, folës në edicionet informative etj. Çdo të diel drejtoi programin e natës për sport, duke realizuar drejtpërdrejt me qindra intervista me trajnerë, drejtues klubesh, federatash, sportistë, gjyqtarë etj. nga të gjitha degët sportive. Përveç në radio, u angazhua edhe në mediet e shkruara, si në gazetën “Dita”, “24 orë”, “Nacional”, “Focus” dhe në agjencinë e lajmeve “Kosovapress” dhe Radio-Kosova. (Florim Maliqaj)

SYLA Mustafë (1969-). Mundës. Lindi në Prishtinë. Shkollën fillore, të mesme dhe Fakultetin e Kulturës Fizike i përfundoi në Prishtinë. Hapat e parë në mundje i bëri si 10-vjeçar në klubin e mundjes “Prishtina”. Ka bërë gara në kategoritë 48, 52 dhe 57 kilogramë. Si 12 -vjeçar fitoi titullin e kampionit të Kosovës (1981), sukses që e përsëriti pandërprerë deri në vitin 1990. Nga viti 1983 e deri më 1990 shtatë herë u shpall kampion i ish-Jugosllavisë. Ishte dy herë kampion i Ballkanit (1985,1986), kampion i Europës në Bursa të Turqisë (1985 dhe 1989) dhe kampion i botës në Francë (1985). Ishte fitues i shumë turneve ndërkombëtare të mbajtura nga viti 1983 e deri më 1990. Arriti normën për Lojërat Olimpike Verore të vitit 1992 në Barcelonë, por nuk shkoi për arsye të gjendjes politike në Kosovës. Nga viti 1990 e deri më 1993 ishte anëtar i përfaqësueses së Zvicrës në mundje. (Lulzim Shala)

SYLA Sylejman (1949-2002). Shkrimtar. Lindi në fshatin Brainë të Podujevës. Kreu shkollën fillore në Orllan, të mesmen në Prishtinë. Mbaroi studimet universitare dhe pasuniversitare për gjuhë dhe letërsi shqipe në Universitetin e Prishtinës. Që në shkollë fillore nisi të shkruajë vjersha dhe skica për fëmijë. Një kohë punoi në gazetën e studentëve “Bota e re”, pastaj në Radio-Prishtina dhe së fundi në Redaksinë e revistave të “Rilindjes”, në fillim si lektor, më vonë redaktor në revistat “Fjala” dhe “Shkëndija”. Përveç shkrimeve për fëmijë, që i botoi në librin “Lypsari i vogël” (1972), më vonë shkroi edhe poezi për të rritur (“Rob i lumtur”, 2002) dhe kritikë letrare dhe studime të letërsisë bashkëkohore. Nga fusha e kritikës botoi librat: “Për kritikën” (1982), “Kritika dhe vepra” (1988), “Interkomunikimi letrar” (1990) dhe “Konflikti i përhershëm” (1997). (Hasan Hasani)

SYLA Shemsi (1957-). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Lindi në Bresalc të Gjilanit. Kreu shkollën e mesme në Gjilan, ndërsa studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe i mbaroi në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës. Si student mori pjesë në organizimin e demonstratave të vitit 1981, me çrast u burgos dhe u dënua. Për herë të dytë u arrestua pas demonstratave të vitit 1989, duke u mbajtur në izolim në burgun e Vranjës, të Zajçarit dhe të Prokuples. Gjatë viteve 1996-

1998 punoi në shkollën fillore të Bresalcit. Në vitet 1998-1999 ishte zëvendëskomandant i UÇK-së në Zonën Operative të Karadakut (ZOK), korrespondent i Agjencisë së lajmeve “Kosovapress” dhe i Radios “Kosova e lirë”, si dhe përgjegjës për marrëdhënie me publikun në ZOK. Pas transformimit të UÇK-së u përfshi në Trupat Mbrotjtëse të Kosovës (TMK) deri më 2009 dhe më pas në Forcën e Sigurisë së Kosovës. (Ali Uka)

SYLA Xhevat (1956-). Shkrimtar, studiues i letërsisë. Lindi në Istog. Mbaroi studimet për letërsi dhe gjuhë shqipe në Universitetin e Prishtinës. Po aty kreu studimet pasuniversitare dhe u doktorua në




XHEVAT SYLA

fushën e letërsisë për fëmijë. Në periudhën 1975-1983 pati funksione të larta politike në organizatën e rinisë në Kosovë. Punoi si kryeredaktor i gazetës “Bota e re” (1979-1982), kryeredaktor i Entit të Teksteve dhe Mjeteve Mësimore të Kosovës (1984-1997) dhe redaktor në Shtëpinë Botuese “Libri shkolllor” në Prishtinë. Ka botuar një numër artikujsh dhe punimesh shkencore nga fusha e letërsisë për fëmijë dhe artikuj e shkrime të shumta publicistike. Është autor e bashkautor në disa libra leximi. Drejton edhe Karvanin e shkrimtarëve për fëmijë “Agim Deva”. Është prezantuar në disa antologji dhe panorama të krijimtarisë letrare për fëmijë. Është laureat i çmimit “Ymer Elshani”, çmimit “Vehbi Kikaj”. Veprat e botuara: “Syri i pranverës” (1976), “Hyrje në vjeshtë” (1993), “Vjersha e humbur” (1996), “Arti i porosisë” (1998), “Zilja e fëmijërisë” (2002), “Harmonika e atdheut” (2005), “Kush e shkruan poezinë” (2005), “Universi i mirësisë” (2010), “Vel vjeshte” (2009), “Kuvendim poetik” (2010) etj. (Zejnullah Rahmani)

SYLA Ylber (1968-). Karateist. Lindi në Prishtinë. Shkollën fillore, të mesme dhe Fakultetin e Kulturës Fizike i kreu në Prishtinë. Hapat e parë të karatesë i bëri në klubin e karatesë “Kosova”. Është kampion i Kosovës (1981-1990) në konkurrencën e juniorëve dhe seniorëve. Ishte fitues edhe i medaljes së bronzë në kampionatin e ish-Jugosllavisë të vitit 1986. Ishte anëtar i përfaqësueses së ish-Jugosllavisë

(1986-1989) dhe anëtar i përfaqësueses së Kosovës (1990-1997), kampion në turnetë ndërkombëtare "Taixhi Kaze" në Frankfurt dhe "Bohemia Cup" në Çeki. (Lulzim Shala)

SYLAJ Ragip (1959-). Shkrimtar, gazetar. Lindi në fshatin Sllapuzhan të Suharekës. Kreu shkollimin fillor në vendlindje, të mesmin në Suharekë, ndërsa studimet për gjuhë dhe letërsi në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës. Punoi si gazetar i kulturës në të përditshmet "Bota sot" dhe "Zëri", ndërsa tash është zyrtar i lartë për publikime në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Kosovës. Botoi përmbledhjet me poezi: "Hije e gjallë" (1986), "Anatomia e rrënjës" (1989), "Lisi i shenjtë" (1993), "Mëngjes qumështor me akull" (2000), "Eliksir" (2007), "Hiri i fjalës" (2014), pastaj përmbledhjet me tregime: "Obsesion" (1992), "Përhitja" (1996), "Humbella e fërgëllisë" (2001), "S'kam kohë të jetoj me vdekjen" (2004), "Hija e shtëpisë" (2008), librin me ese "Estetika e misterit" (2008), librin me vjersha për fëmijë "Ma jep dorën" (2010), "Dy drama" (2012). U shpërblye me disa çmime letrare, siç është çmimi "Hivzi Sulejmani" i Shoqatës së Shkrimtarëve në vitin 1986, për librin poetik "Hija e gjallë", ndërsa në vitin 1999 u nderua me "Penën e artë" të revistës për kulturë, art dhe letërsi "Fjala". Është laureat i çmimit të parë "Kadmus-2006" për ese në Athinë etj. (Adil Olluri)



RAGIP SYLAJ

SYLANAJ Sylë (1952-). Pemëtar, profesor universiteti. Lindi në Llaushë të Skënderajt. Shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në vendlindje, Fakultetin e Bujqësisë, drejtimi i përgjithshëm, e kreu në Prishtinë (1979). Ka qenë studenti i parë i diplomuar në gjuhën shqipe në këtë fakultet. U punësua praktikant në administratën komonale të Skënderajt dhe në shkollën e mesme "Ramiz Sadiku" mësimdhënës i lëndëve të bujqësisë (1979-80). Në vitin 1980 punësohet në Fakultetin e Bujqësisë në Prishtinë. Ka qenë



SYLË SYLANAJ

zv/sekretar Krahinor i Bujqësisë. Studimet pasuniversitare i kreu në Fakultetin e Bujqësisë të Universitetit të Zagrebit (1989), ndërsa tezën e disertacionit e mbrojti në Fakultetin e Bujqësisë të Universitetit të Prishtinës (2002). Kreu specializime në Institutin për Hulumtime Shkencore për Pemëtarin në Plovdiv të Bullgarisë (1985-87). Mori pjesë në përpilimin e disa projekteve për ngritjen e pemishteve të reja në Kosovë. Botoi punime shkencore e profesionale dhe disa libra për pemëtarinë ("Dredhëza", "Bujqësia organike", bashkautor). Mori pjesë me kumtesa në tubime shkencore brenda dhe jashtë vendit. (Agim Zajmi)

SYLA-SURROI Blerta (1978-). Aktore, pikto. Lindi në Prishtinë. Kreu shkollimin fillor e të mesëm në Prishtinë, ku mbaroi dhe studimet për grafikë në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. Është aktore teatri dhe filmi. Nga viti 1999 disa vjet punoi në Teatrin Kombëtar të Kosovës në Prishtinë, ku realizoi role në shfaqjet "Të mallkuarit", "Makbethi", "Fausti III", "Ëndrra e një nate vere", "Muzgu i lirisë", "Kutia e zezë", "Komploti ilir", "Daja Vanja" etj. Realizoi role në filmat "Vjeshta e trëndafilave", "Anatema", "Fillimi i fundit", "Lufta mbaroi" etj. Luajti dhe në serialet televizive "Rrëfime para gjyqi", "Familja moderne" etj. Si artiste figurative u paraqiti në ekspozita personale në Prishtinë (Muzeu i Kosovës, 2012), në Shkup (Qendra Kulturore, 2014), pastaj Tiranë (Muzeu Kombëtar, 2015), si dhe në disa ekspozita kolektive në Prishtinë, Tiranë, Shkup, Tokio, Bombai, Paris, Napoli, Zagreb, Rijekë etj. (Rexhep Ferri)

SYLEJMAN HADIM AGA (shek. XVI). Administrues i lartë në pallatin e sulltanit. Lindi në fshatin Guskë të rrethit të Gjakovës, prej nga u mor devrshirm në gjysmën e parë të shk. XVI. Në burimet osmane njihet si Bi-zëban Sylejman Hadim aga, që do të thotë "i pa gojë" apo "memec". Nga një studim i fundit mësohet se ka qenë shërbyes i preferuar i sulltaneshës Safije, gruas së sulltan Muratit III dhe e ëma e sulltan Mehmetit III, e cila, sipas burimeve venedikase, ishte shqiptare nga sanxhaku i Dukagjinit. Dihet po ashtu se Sylejman Hadim aga e kishte financuar ndërtimin e Teqesë Etjemez (tarikati saadi) në lagjen Samatja të Stambollit. Ndërtimi i Xhamisë së Hadumit, që lidhet me emrin e tij, është bërthama e parë e

kasabasë së ardhshme të Gjakovës, duke u bërë qendër e rëndësishme ekonomike e zonës së Dukagjinit. (Kushtrim Shehu)

SYLEJMANI Bajram (1965-1998). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), dëshmor. Lindi në fshatin Sodovinë. Mbaroi shkollimin fillor në fshatin e lindjes dhe në Gushicë, të mesmen në Viti. Kreu Fakultetin Xehetar-Metalurgjik të Mitrovicës, dega e gjeologjisë, në vitin 1991. Në shtator të vitit 1998 u burgos bashkë me të vëllanë, Gurselin. Nga fundi i viteve '80 ishte aktiv në veprimtari patriotike, veçmas në organizimin e grevës së studentëve në shkurt të vitit 1989, në shenjë solidariteti me grevën e minatorëve të Stantërgut. Pas diplomimit, së bashku me të vëllanë Gurselin, hapën një punëtori dizajni. Me shpërthimin e luftës së UÇK-së u rreshtua në radhët e para të saj në Zonën Operative të Nerodimes, ku u caktua në detyra drejtuese. Më 28 shtator 1998 ra në frontin e luftës, ndërsa vetëm një orë më pas, u vra edhe vëllai i tij, Gursel Sylejmani. (Sylë Ukshini)

SYLEJMANI Fadil (1940-2013). Albanolog, profesor. Lindi në fshatin Bozovcë të Tetovës. Shkollimin e mesëm e kreu në Tetovë, në Prizren kreu Shkollën e Lartë Pedagogjike, studimet për gjuhë dhe



FADIL SYLEJMANI

letërsi shqipe i mbaroi në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Studimet pas-universitare i kreu në Beograd, ndërsa doktoroi në shkencat filologjike në Universitetin e Prishtinës për të folmen e Malësisë së Tetovës (1989). Ishte mësimdhënës në degën e gjuhës dhe të letërsisë shqipe të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës që nga viti 1972. Më 1990 organizoi konferencën shkencore me temë "Shqiptarët e Maqedonisë", ku morën pjesë albanologë të të gjitha trevave shqiptare. Një vit më vonë themeloi Bashkësinë Kulturore Shqiptare. Shkroi për veçoritë morfologjike të gjuhës së Lekë Matrëngës, për fjalësin e Matrëngës, për grafinë e tij, si dhe për toponiminë e Malësisë së Tetovës. Ishte rektor i parë i Universitetit të Tetovës (1994). Shkroi disa libra për kulturën dhe gjuhën gjermane, si: "Njohuri për Gjermaninë dhe popullin e saj"

(1995), "Fonetika e gjuhës gjermane" (1995), "Morfologjia e gjuhës gjermane" (1995) etj. Botoi këto monografi studimore: "E mbsuame e krishterë e Lekë Matrëngës" (1979), "Praktikum i gjuhës së sotme shqipe" (1981), "Lindja, martesja dhe vdekja në Malësinë e Tetovës" (1988) etj. (Berton Sulejmani)

SYLEJMANI Fehmi (1934-). Mësimdhënës veteran. Lindi në fshatin Tërnavë të Preshevës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa gjimnazin e ulët në Preshevë. Shkollën normale e kreu pa shpëputje nga puna në Prizren, Vranjë e në Prishtinë. Mbaroi edhe studimet për gjuhë e letërsi shqipe në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prizren dhe në Fakultetin Filozofik në Shkup. Ende pa arsim të mesëm emërohet mësues në disa fshatra: në Sefer të Kradakut të Preshevës, në Miratoc, në Preshevë e Rahovicë. Në vitin shkollor 1973/74 emërohet drejtor i shkollës fillore "Selami Hallaçi" në Rahovicë, pastaj këshilltar pedagogjik në Entin për Përparimin e Arsimit dhe Edukimit në Vranjë dhe mësimdhënës në Shkollën fillore "15 Nëntori" në Preshevë. (Gafur Hyseni)

SYLEJMANI Fehmi (1965-). Gazetar. Lindi në Zabcicë, komuna e Bujanocit. Shkollimin bazë e kreu në Gjilan, ndërsa studimet në Fakultetin e Edukimit, drejtimi matematikë-informatikë në Gjilan. Punoi mësimdhënës në gjimnazin "Zenel Hajdini", në shkollën 9-vjeçare "Selami Hallaçi" në Gjilan dhe më pas edhe në shkollën e mesme të ulët "Rexhep Elmazi" po në Gjilan. Karrierën si gazetar i sportit e nisi më 1997 për gazetën javore "Sport plus", kurse gjatë periudhës 2000-2005 ishte korrespondent i sportit në gazetën "Koha ditore" dhe në periudhën 2005-2008 në gazetën "Lajm". Nga shtatori i viti 2008 ishte gazetar-korrespondent i gazetës "Epoka e re" deri në fund të vitit 2011. (Veli Bytyçi)

SYLEJMANI Gursel (1961-1998). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), dëshmor. Lindi në Sodovinë të Jerlive të Vitisë. Pasi kreu shkollën e mesme, ndoqi studimet në Shkollën e Lartë të Artit në Shkup. Pak kohë punoi si mësimdhënës i artit figurativ. Që në rini u përfshi në lëvizjen ilegale patriotike. U arrestua në dhjetor të vitit 1982 dhe u dënua me 8 vjet burg. Në shtator të vitit 1988 u burgos sërish. Nuk qëndroi gjatë në burg, por u torturua rëndë. Më 27 mars 1989 u

burgos për herë të tretë dhe u mbajt për disa muaj në izolim, pa vendim gjyqi. Në fillim të viteve '90 në Ferizaj hapi atelienë e tij dhe u bë anëtar aktiv i Shoqatës së Artistëve të Ferizajt "Zef Kolombi". Gjatë kësaj periudhe hapi një varg ekspozitash individuale dhe mori pjesë në ekspozita kolektive. Që nga fillimi ishte në kontakt me themeluesit e njësiteve të para të UÇK-së në rajonin e Ferizajt. Ishte ndër luftëtarët e parë në Zonën Operative të Nerodimes dhe ndër drejtuesit e luftës në këtë zonë. Më 28 shtator 1998 ra heroikisht, duke luftuar kundër forcave serbe. Më 2010 u dekorua nga presidenti i Kosovës me medaljen "Adem Jashari." (Sylë Ukshini)

SYLEJMANI Haki (1937-). Mësimdhënës dhe veprimtar. Lindi në Tërriç të Preshevës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa gjimnazin e ulët në Preshevë. Shkollimin e mesëm e vazhdoi në gjimnazin e Gjilanit. Pa shkëputje nga puna mbaroi studimet për gjuhë e letërsi shqipe në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Shkup, pastaj edhe në Fakultetin Filozofik në Prishtinë. Punës së mësuesit ia filloi në Miratoc të Preshevës, ku punoi deri në vitin 1960, pastaj në Raincë, në shkollën fillore të Preshevës, më vonë referent për arsim, kulturë dhe kulturë fizike, inspektor i arsimit, drejtor i universitetit të punëtorëve në Preshevë, këshilltar pedagogjik në Entin për Përparimin e Arsimit dhe Edukimit në Vranjë etj. (Gafur Hyseni)

SYLEJMANI Lorik (1972-). Dizajner. Lindi në Prishtinë. Studimet për dizajn grafik i kreu në Fakultetin e Arteve në Prishtinë (1994). Krijimtaria e tij artistike përfshin artin digjital, fotografinë dhe dizajnin si kombinim. Realizoi disa ekspozita personale dhe mori pjesë në një sërë ekspozitash kolektive në Kosovë dhe jashtë, si: Itali (2004), Argentinë (2004), Francë (2004), Rusi (2005) SHBA (2006, 2014), Belgjikë (2010), Angli (2010) etj. Në periudhën 2002-2011 ishte autor i emisionit televiziv "Aveny" në Radiotelevizionin e Kosovës, si dhe autor

i disa dokumentarëve televizivë për Japoninë (2005), për Bienalen e Venecias (2007), për "Glastonbury festival" në Britaninë e Madhe (2008-2010), i një dokumentari për artisten L. Anderson (2007), për bendin "Laibach" (2008) etj. (Zeni Balazhi)

SYLEJMANI Shaban (1924-1996). Mjek, atdhetar. Lindi në Ferizaj, arsimimin bazë e mori në vendlindje, kurse në Shkup kreu Medresenë e Madhe. Fakultetin e Mjekësisë e përfundoi në Beograd (1951). Pas studimeve, një kohë të shkurtër punoi në Pejë, kurse më pas u transferua në Ferizaj, ku u emërua drejtor i stacionit të parë shëndetësor (1953). Në valën e shpërnguljeve të shqiptarëve të Kosovës për në Turqi u persekutua dhe u detyrua me dhunë të shpërngulet nga Ferizaj në vitin 1956, duke ia konfiskuar edhe shtëpinë. U vendos në Shkup ku punoi dy vjet, më pas emigroi për në Turqi. Atje do të punojë së bashku me të vëllanë e tij kirurg, duke ndihmuar komunitetin shqiptar të Stambollit. Vdiq në Stamboll. (Agim Bytyçi)

SYLEJMANI Xhafer (1878-1953). Mjek, atdhetar, politikan. Lindi në një fshat të Skraparit. Shkollohet në Stamboll, u diplomua më 1905 në Fakultetin e Mjekësisë në Stamboll. Kreu studimet pasuniversitare në Universitetin e Sorbonës në Francë. Praktikën dyvjeçare mjekësore e kreu në Janinë, një kohë të shkurtër e ushtroi profesionin e tij në Gostivar, kurse më 1908 u vendos në Tetovë, ku mbetet deri në fund të jetës. Ishte i pari mjek i diplomuar në Tetovë. Gjatë luftërave ballkanike dhe Luftës së Parë Botërore u mobilizua nga ushtria dhe u zu rob. Pas lirim të sërish vazhdoi profesionin e mjekut. Më 1927 u zgjodh deputet dhe në këtë post qëndroi deri në vitin 1941, kur u zgjodh kryetar i Bashkisë së Tetovës. Në vitin 1944 u burgos dhe u dënua me 18 muaj burg. Në vitin 1946, tashmë i moshuar, sërish u burgos dhe u dënua me 6 vjet burg. Më 1950, pasi i vuajti 4 vjet burg, për shkak të moshës dhe shëndetit të lig, u lirua nga burgu. Tre vjet më vonë vdiq në Tetovë. (Remzi Izairi)

SH

SHABANI Avni (1955-). Gazetar. Lindi në Sazli të Ferizajt. I përfundoi studimet për gazetari në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës. Një kohë përgatiti rubrikën e sportit në Radio-Ferizaj. Nga viti 1982 punoi për të përditshmen “Rilindja”, si korrespondent nga Ferizaj, pastaj edhe tek e përditshmja “Bujku”. Pas luftës vazhdoi të punonte në “Rilindje”, deri në shuarjen e saj. Ka bashkëpunuar edhe me disa medie sportive të Zagrebit, Sarajevës dhe të Beogradit deri në vitin 1989. Pas luftës ishte drejtor i Radio-Ferizajt, më pas drejtor i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë e Sportit në komunën e Ferizajt. Nga viti 2009 punon gazetar i sportit në Radio-Kosovë. (Edmond Thaçi)

SHABANI Bajram (1922-1941). Aktivist i lëvizjes antifashiste në Maqedoni, Hero i Popullit. Lindi në fshatin Likovë të Kumanovës. Që herët ra në kontakt me idetë komuniste dhe u përfshi në organizimet politike të qytetit. Në prag të Luftës së Dytë Botërore u pranua në radhët e Rinisë Komuniste të Jugosllavisë. U radhit përkrah lëvizjes ilegale, e më pas në lëvizjen e armatosur në rajonin e Karadakut të Kumanovës kundër pushtuesit bullgar. Më 1941 ishte ndër të parët që u rreshtua në aradhën partizane të Karadakut. Gjatë një marshimi të aradhes drejt fshatit Bellanoc, partizanët u rrethuan nga xhandarmëria bullgare. Në përpjekje për të çarë rrethimin, ra në betejë më 11 tetor 1941. Më 1952 u shpall Hero i Popullit. (Ramiz Abdyli)

SHABANI Bajram (1947-). Inxhinier i minierave, profesor universiteti. Lindi në Dobriçhë të Gjakovës, shkollën fillore e kreu në fshatin Gramaçel, të mesmen në Gjakovë, studimet në Fakultetin e Gjeologjisë dhe të Minierave në Tuzëll (1974), kurse ato pasuniversitare në Universitetin e Zagrebit. Disertacionin e mbrojti në Fakultetin e Gjeologjisë dhe të Minierave të

Universitetit Politeknik të Tiranës (1994). Punoi në minierën “Boksitet e Kosovës” (1974), ndërsa më 1995 kaloi në marrëdhënie pune në Fakultetin e Xehetarisë dhe të Metalurgjisë të Universitetit të Prishtinës në Mitrovicë, në fillim ligjërues për lëndën teknologjia e shfrytëzimit sipërfaqësor, kurse më pastaj ishte titullar edhe i lëndëve: hulumtimet e lëndëve të para minerale dhe shpimet kërkimore me injektim. Është autor i teksteve universitare “Hulumtimi i vendburimeve të lëndëve të para minerale” (1977) dhe “Shpimet kërkimore me injektim” (1999), bashkautor i monografisë “Boksitet e Kosovës” (1986) si dhe autor e bashkautor i një sërë punimesh shkencore dhe profesionale. Ishte udhëheqës dhe bashkëpunëtor në një sërë projektesh nga lëmi i minierave. (Islam Fejza)

SHABANI Haxhi (1963). Gjuhëtar, gazetar, mësimdhënës universitar. Lindi në Anë të Malit të Ulqinit, në Mal i Zi. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Ulqin, studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës (1987). Është magjistruar më 2006 me temën “Dygydhësia te shqiptarët e Ulqinit”. Më 2007 ka publikuar librin “Rrezikimi i gjuhës shqipe”, ndërsa më 2013 librin me analiza “Shqiptarët në Malin e Zi, çështje e pazgjidhur”. Me gazetari merret që nga vitet nëntëdhjetë, duke qenë korrespondent i disa gazetave, revistave e agjencive në Kosovë dhe Mal të Zi. Nga viti 2008-2012 ishte kryetar i Shoqatës së Krijuesve “Art Club” nga Ulqini. Në vitin 2010 botoi përmbledhjen me poezi “Jam ai që nuk jam”, kurse në vitin 2011 poezia e tij u botua në kuadër të librit me krijimtari letrare: “Pesë shkrimtarë shqiptarë në Malin e Zi” (Pet albanskih književnika u Crnoj Gori). Mban kurse të gjuhës shqipe në Universitetin e Podgoricës. (Bardh Rugova)

SHABANI Idriz (1958-). Ushtarak, komandant i brigadës 151 “Zahir Pajaziti” të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) në Zonën Operative të Llapit. Lindi në fshatin Orllan të komunës së Podujevës. Pasi kreu shkollimin fillor dhe të mesëm në vendlindje dhe në Podujevë, përfundoi Akademinë Ushtarake të Artilerisë në Banja Llukë, Bosnjë dhe Hercegovinë (1984). Ishte epror në ushtrinë e ish-Jugosllavisë. Me shpërthimin e luftës në Kosovë, më 2 korrik të viti 1998 u aktivizua në strukturat e UÇK-së në Zonën Operative të Llapit për përgatitjen e vullnetarëve. Në korrik të vitit 1998 u emërua në detyrën e komandantit të brigadës së dytë në Zonën Operative të Llapit. Me ristrukturimin e njësiteve ushtarake në Zonën Operative të Llapit, në dhjetor të vitit 1998 I. Shabani u emërua komandant i Brigadës 151 “Zahir Pajaziti”. Detyrën e komandantit të brigadës e kreu deri në përfundim të luftës. Pas transformimit të UÇK-së ishte pjesëtar i Trupave Mbrojtëse të Kosovës dhe të Forcës së Sigurisë së Kosovës. (Ismet Cakiqi)

SHABANI Isak (1964-). Veprimtar, bashkëthemelues i celulave të para të rezistencës së armatosur në Llap. Lindi në fshatin Orllan të komunës së Podujevës. Mori arsimin fillor në vendlindje, shkollën e mesme në Orllan dhe Prishtinë, studimet në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës. Bënte pjesë në rrethin e parë të shokëve të Zahir Pajazitit për krijimin e celulave të para të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Llap. Nga shkurti i vitit 1994 u përfshi në organizimet ushtarake të drejtuar nga Z. Pajaziti. Disa ditë pas vrasjes së Z. Pajazitit, u kidnapua nga policia serbe dhe u dënua nga Gjykata e Prishtinës me 10 vjet burg. Dënimin e vuajti në Burgun e Dubravës, ku përjetoj edhe masakrën e njohur të Burgut të Dubravës. U lirua nga burgjet serbe në mars të vitit 2001. (Ismet Cakiqi)

SHABANI Muharrem (1922-1982). Titullar i fesë islame. Lindi në fshatin Përlepnice të Gjilanit. Mësimet e para fetare i mori në fshatin e lindjes, kurse medresenë e kreu në Gjilan. I vazhdoi studimet në Universitetin e “Al-Az-har-it” në Kajro, ku edhe u diplomua në shariat. Për shkak të ardhjes së komunistëve në pushtet, pas Luftës së Dytë Botërore nuk u kthye në Kosovë. Më 1945 u shpërngul për në Arabinë Saudite, ku një kohë punoi si pedagog

shkolle në qytetin e Xhedës dhe më pas në Radio Xhedë, si redaktor në departamentin e lajmeve. U angazhua në aktivitete të ndryshme për çështjen shqiptare, veçmas qe aktiv në kuadër të Ligës Islame, ku ishte anëtar. Bëri punë të çmuar në demaskimin e propagandës jugosllave në vendet arabe për gjendjen e shqiptarëve në ish-Jugosllavi. Vdiq në Xhedë të Arabisë Saudite. (Qemajl Morina)

SHABANI Ramadan (1861-1931) Veprimtar i lëvizjes për pavarësi dhe bashkim kombëtar. Lindi në fshatin Cerovik të Klinës. Gjatë kryengritjeve të viteve 1910-1912 ishte pjesëmarrës aktiv në aksionet e armatosura. Mori pjesë në Kuvendin të Verrat e Llukës më 1910. Ishte ndër prijësit e luftëtarëve të Llapushës në betejën e Carralevës dhe në kryengritjen e vitit 1912, si dhe pjesëmarrës në Kuvendin e Junikut. Luftoi në Plavë, Guci dhe Rugovë, kundër forcave malaziasë. Ishte njëri ndër udhëheqësit ushtarakë në kryengritjen e vitit 1919. Pas shuarjes së kryengritjes, iku në Shqipëri. Atje vazhdoi aktivitetin në Komitetin “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”. Në korrik 1920-1921 luftoi në Kopluk, kundër ndërhyrjes jugosllave. Në vitin 1921 kthehet në Kosovë. Si pleqnar pajtoi familjet dhe hasmëri të ndryshme. Ishte me autoritet dhe e quanin kryepelnari i Kosovës. Vdiq në fshatin Kijevë. (Lush Culaj)

SHABANI Resul (1944), Poet, tregimtar, dramaturg, përkthyes. Lindi në Kalishtë të Strugës. Kreu shkollën fillore dhe të mesme në Strugë. Mbaroi studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Shkup e Prishtinë. Ishte arsimtar i gjuhës shqipe, ndërsa nga viti 1971 punoi në gazetën “Flaka e vëllazërimit” në Shkup, si gazetar e redaktor i kulturës. Një kohë ka drejtuar revistën “Jehona”, pastaj ka qenë redaktor përgjegjës



RESUL SHABANI

i Shtëpisë Botuese “Flaka”. Shkruan poezi, tregime, drama, përkthen nga maqedonishtja në shqip dhe nga shqipja në maqedonisht. Ka botuar këta libra: “Liqeni” (tregime, 1974) “Peshk” (poezi 1975), “Hamleti me plis të zi”, (poezi, 1978), “Shën” (tregime 1978), “Anija e vjetër” (dy drama, 1982), “Ora e liqenit”, (poezi, 1983), “Dashuria e kapitenit”, (roman, 1983),

“Ujëpërshkruesi i fushës”, (poezi 1986), “Fani vjen vetëm”, (tri drama, 1987), “Oh, Amerika”, (poezi, 1989), “Qerpik i lagur”, (tregime 1994), “Shtatë drama” (1999), “Nuse vale”, (tregime, 2001), “Përsëri për shelgun vajtues”, (2004), “Vitrina e skenës”, (drama, 2010), etj. Librat e tij janë përkthyer në maqedonisht, rumanisht, anglisht, poezi e zgjedhur është botuar në Shkup, Prishtinë, Tiranë., ndërsa dramat e tij janë inskenuar në skenat e teatrove profesionale dhe amatore. Poezia dhe tregimet janë përfaqësuar në antologji në gjuhën shqipe dhe në disa gjuhë të huaja. Është laureat i disa çmimeve prestigjioze për veprimtarinë e tij si poet, tregimtar e përkthyes. Ka marrë pjesë në shumë manifestime letrare ndërkombëtare. (Eqrem Basha)

SHABANI Shaban (1948-). Inxhinier i makinerisë, profesor universiteti. Lindi në fshatin Zhunicë të Preshevës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, të mesmen në Preshevë, kurse studimet në Fakultetin Teknik



SHABAN SHABANI

në Fakultetin Teknik në Prishtinë (1973). Kreu studimet pasuniversitare në Zagreb, ndërsa doktotori në Fakultetin e Makinerisë të Universitetit të Pri-shtinës (UP) (1995). Pas diplomimit punoi në shkollat të mesme në Gjilan dhe Bujanoc. Ishte drejtor teknik dhe ushtrues detyre i drejtorit të përgjithshëm në Organizatën punuese “Metal” të Preshevës. Në vitin 1979 u zgjodh në Fakultetin e Makinerisë, më pas avancohet në tituj të tjerë (profesor i rregullt, 2002) për lëndët rregullimi automatik dhe automatizimi i proceseve prodhuese. Në Fakultetin e Makinerisë ushtroi funksione të ndryshme. Botoi disa tekste universitare: “Teknika e rregullimit, përmbledhje detyrash të zgjedhura” (1998), “Dirigimi dhe rregullimi automatik” (2002) etj. Me punime shkencore mori pjesë në simpoziume dhe konferenca dhe botoi disa punime shkencore dhe profesionale. Për nevojat e ekonomisë së Kosovës kreu projekte të ndryshme nga lëmi i makinerisë. (Musli Bajraktari)

SHABANI Ymer (1937-). Veteran i arsimit, veprimtar. Lindi në Preshevë, shkollën fillore e mbaroi në vendlindje, ndërsa normalen në Shkup. Studioi matematikën pa shkëputje nga

puna në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Vranjë. Punoi në shkollën fillore në Miratoc, pasaj në Preshevë. Ishte mësimdhënës i matematikës në gjimnazin “Skënderbeu” të Preshevës. U mor edhe me enigmatikë, me organizimin e garave të diturisë me nxënës, me aktivitete folklorike në Shoqërinë kulturore-artistike “Abdullah Krashnica” në Preshevë. (Gafur Hyseni)

SHAHINI Remzi (1946-). Inxhinier i makinerisë. Lindi në Kumanovë, shkollimin fillore dhe të mesëm i kreu në vendlindje, studimet në Fakultetin Teknik të Universitetit të Prishtinës (1973). Bëri specializime profesionale për riparime kapitale të pajisjeve energjetike në Spanjë, në Poloni për pajisjet e kaldajave, në ish-BRSS për riparimet kapitale, për turbina e gjeneratorë dhe në Holandë për vibrime dhe balancime dinamike të makinave rrotulluese. Ushtrroi funksione drejtuese në Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK): drejtor teknik i termocentraleve “Kosova A” (1984-1985), drejtor i teroteknologjisë i termocentraleve “Kosova A” dhe “Kosova B” (1985-1990), drejtor operativ i KEK-ut (2008-2011), ushtrues detyre dhe drejtor menaxhues i KEK-ut etj. (Fehmi Krasniqi)

SHAHIQI Muharrem (1927-1997). Aktor, regjisor, dramaturg. Lindi në Gjyrishec të Kamenicës. Shkollën fillore e kreu në Gjilan, ndërkaq të mesmen në Prizren dhe në Beograd. Punoi si mësues në fshatra të Kamenicës. Nga viti 1950, për plot 28 vjet, ishte aktor në Teatrin e Kombësive në Shkup (Drama Shqipe), ndërsa nga viti 1976 në Teatrin e Gjilanit, ku punoi si aktor dhe regjisor. Luajti mbi 100 role të ndryshme në shfaqjet: “Hakmarrja”, “Koshtana”, “E ikura”, “Kryekungulli”, “Zona e Zamfirrit”, “E shoqja e Hasan Agës”, “Kryet e hudrës”, “Aradha diellore”, “Çajhania në hënën e gushtit”, “Zonja ministreshë”, “Karnavalet e Korçës”, “Paratë janë vrasëse” etj. Ishte autor i tekstit të dramës “Varret e pafajshme” dhe të dy komedive “Një natë në hotel” dhe “Rrëshqitëza”, që gjithashtu u inskenuan në Tetarin e Gjilanit. Në këtë teatër bëri edhe regjinë e disa shfaqjeve teatrore: “Dasmë në luftë”, “Kryet e hudrës”, “Një natë në hotel”, “Rrëshqitëza” etj. Luajti edhe në filmat: “Kapetan Lleshi”, “Prej fitores e pas”, “Uka i Bjeshkëve të Nemuna”, “Era dhe Lisi” etj., si dhe në disa drama dhe seriale televizive. Ishte autor edhe i një sërë shkrimesh nga fusha e letërsisë. (Erson Zymberi)

SHAHIQI Sabedin (1949-). Aktor. Lindi në Gjilan, ku kreu arsimin fillor dhe të mesëm. Studimet për aktrim i kreu në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prishtinë. Më 1971 u punësua



SABEDIN SHAHIQI

në Teatrin e Gjilanit. Në këtë teatër luajti role të shumta në shfaqjet: “Familja e peshkatarit”, “Varret e pafajshme”, “Hamleti në Katranicën e Poshtme”, “Aradhja qiellore”, “Dasmë pa nuse”, “Certifikata e kurorëzimit”, “Vdekja e turpshme”, “Monserati”, “Një natë në hotel”, “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”, “As parë, as njohur”, “Romeo dhe Zhuljeta”, “Ura e sakrificës”, “Ëndërr apo zhgëndërr”, “Kryet e hudrës”, “Ligatina”, “Banesa e përbashkët”, “Miza në vesh”, “Buleta e llotarisë”, “Rekuiei”, “Trokitje”, “Ditëlindja” etj. Bëri gjithashtu regjinë e shfaqjeve: “Varre të pafajshme”, “Halili dhe Hajria”, “Hakmarrja”, “Cilindri magjik” etj. Përveç në teatër, luajti edhe në filmat: “Era dhe Lisi”, “Kur pranvera vonohet”, “Lepuri me pesë këmbë” dhe “Kur shpirti ndërron jetë”. U nderua me mirënjohje të ndryshme nga institucionet kulturore të Kosovës dhe të ish-Jugosllavisë. (Erson Zymberi)

SHALA Abdurrahman (1922-1994). Aktor, regjisor. Lindi në Vushtrri. Vijoi mësimet për aktrim në Beograd. Nga viti 1948 nisi punën në Teatrin Krahinor Popullor në Prishtinë si aktor



ABDURRAHMAN SHALA

dhe regjisor. Si regjisor realizoi mbi 35 shfaqje, ndër të cilat: “Zjarri dhe hiri”, “E shoqja e Hasan Agës”, “Tri botëra”, “Dy rreshterët”, “Nuk martohem me parë”, “Kryet e hudrës”, “Miu në xhep”, “Mirandolina”, “Nita”, “Halit Gashi”, “Pjata e drunjtë”, “Cubat”, “Ushtari i mirë Shvejç”, “Profesori Mamlok”, “Një nuse për Stasin”, “Otello” etj. Me shfaqjen “Zhelanët” të M. Borit mori çmimin e parë në Festivalin e Teatrove të Jugosllavisë në Beograd (1952), ku u shpërblye edhe me çmimin e aktorit më të mirë në po të njëjtën shfaqje. Por profilin artistik A. Shala e realizoi si aktor me një mori rolesh në teatër dhe në film. Nga rolet e realizuara në teatër

veçohen shfaqjet: “Zhelanët”, “Rruga në krim”, “Personi i dyshimtë”, “Dasma”, “Mirandolina”, “Shërbëtori i dy zotërinjve”, “Nita”, “Koshtana”, “Othello”, “Dervishi dhe vdekja” etj. Pas vitit 1968, A. Shala u largua nga teatri dhe iu përkushtua kinematografisë ku realizoi me sukses shumë role në filmat: “Rafale në qiell” (1958), “Kapedan Leshi” (1960), “Hakmarrja” (1962), “Kozara”, “Vëllai i dr. Homerit” (1968), “Uka i Bjeshkëve të Nemuna” (1968), “Beteja e Neretvës” (1969), “Rekuiei” (1970), “Balada për gjakpirësin” (1971), “Koka ime e marrë” (1971), “Si të vdiset” (me të cilin rol fitoi çmimin “Arena e bronzte” në Festivalin e Pulës), “Bombahedhësit” (1973), “Sulmi i kuq” (1974), “Kur pranvera vonohet” (1979), “Era dhe Lisi” (1979), “Lepuri me pesë këmbë” (1982), “Përroi vërshues” (1983), “Njeriu prej dheu” (1984), “Gjurmë të rrezikshme” (1984), “Proka” (1985), “Para shiut” (1994) etj. Rolet më të rëndësishme të A. Shalës në film mund të konsiderohen ato në filmat “Uka i bjeshkëve të Nemuna” në regjinë e M. Stamenkoviçit; “Njeriu prej dheu” në regji të A. Sopit dhe “Era dhe Lisi” në regji të B. Sahatçiu. Me qëndrimin e tij burror, me emocione të përmbajtura dhe me gjeste minimaliste, A. Shala krijoi një stil të veçantë të aktrimit, që e bënte njërin ndër aktorët më të çmuar në ish-Jugosllavi. Pos si regjisor dhe aktor, A. Shala kontribuoi edhe për krijimin dhe zhvillimin e Teatrit të Kosovës dhe të shtëpisë filmike “Kosovafilm” (1969), ku ishte drejtor për disa vjet. Për kontributin e tij në zhvillimin e artit skenik dhe kinematografik u nderua me çmime dhe mirënjohje. (Fadil Hysaj)

SHALA Ahmet (1968-). Inxhinier i makinerisë, profesor universiteti. Lindi në Isniq, komuna e Deçanit. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, të mesmen në Deçan dhe Fakultetin e Makinerisë në Uni-



AHMET SHALA

versitetin e Prishtinës (UP). Studimet e magjistraturës dhe të doktoratës i kreu në Fakultetin e Makinerisë të UP-së (2005). Në vitin 1994 u zgjodh asistent dhe më pas avancohet në tituj të tjerë universitarë. Është titullar i disa lëndëve bazë: informatikë dhe programim, softuerët aplikativë, mekanikë teknike, sistemet e informimit në komunikacion

etj. Ushtron aktivitete profesionale në kuadër të bashkëpunimeve për ekonomi në fushën e inspektimeve dhe të certifikimeve, të instalimeve makinerike, si: ashensorë, vinça, teleferikë etj. Është anëtar i komisionit shtetëror për licencim të arkitektëve dhe inxhinierëve. Është autor dhe bashkautor i disa teksteve-dispensa universitare për softuerët aplikativë, për informatikë dhe për programim etj. Ka publikuar një sërë punimesh shkencore dhe profesionale dhe ka marrë pjesë në konferenca shkencore brenda dhe jashtë vendit. (Fehmi Krasniqi)

SHALA Ali (1936-1999). Gazetar i sportit. Lindi në Lushnjë. Shkollimin e mesëm e kreu në Prishtinë. Nisi me punë në gazetën “Rilindja” që në vitin 1955. Në vitin 1958, kur “Rilindja” nisi të dalë e përditshme, bëhet redaktor i rubrikës së sportit, ku krijoi një grup gazetarësh të njohur. Si redaktor i rubrikës së sportit në “Rilindje” punoi deri në vitin 1990. Ndërkohë ndoqi shumë ngjarje vendore dhe ndërkombëtare, duke filluar nga lojërat olimpikë verore, lojërat olimpikë dimërore, e deri te kampionatet botërore e europiane në shumë sporte, sidomos në futboll. (Besim Kajtazi)

SHALA Ali (1940-2012). Inxhinier i ndërtimitarisë, profesor universiteti. Lindi në fshatin Okrashticë të Vushtrrisë. Shkollimin fillor e kreu në Pantinë, të mesmen në Mitrovicë, ndërsa studimet i filloi në Universitetin e Shkupit dhe i përfundoi në Universitetin e Beogradit (1967). Kreu studimet pasuniversitare në Universitetin e Zagrebit, ndërsa disertacionin e mbrojti në Universitetin e Prishtinës (UP) (1993). Pas studimeve u punësua në kombinatin “Trepça” në Mitrovicë dhe më vonë në kombinatin “Ramiz Sadiku” në Prishtinë (1969). U zgjodh asistent, ligjërues (1976), profesor inordinar (2000) për lëndën e hidraulikës në Fakultetin e Ndërtimitarisë dhe të Arkitekturës të UP-së. Është themelues i drejtimit të hidroteknikës në kuadër të Fakultetit të Ndërtimitarisë dhe të Arkitekturës (FNA) dhe kreu detyra udhëheqëse në këtë fakultet. Ishte pjesëmarrës i shumë projekteve në fushën e hulumtimeve të ujërave nëntokësore në Kosovë dhe në disa vende të ish-Jugosllavisë dhe në projekte për rregullimin e lumenjve. (Naser Kabashi).

SHALA Anton (1948-). Pemëtar, profesor universitar. Lindi në Smaç, komuna e Prizrenit.

Shkollën fillore e kreu në vendlindje, gjimnazin në Gjakovë, studimet për pemëtari-vreshtari i kreu në Fakultetin e Bujqësisë të Universiteti të Beogradit (1974). Pas studimeve punësohet në kombinatin bujqësor “Ereniku” në Gjakovë (1974) dhe në kombinatin bujqësor-industrial “Progres-Export” në Prizren (1978). Në vitin 1979 zgjidhet asistent për lëndët e pemëtarisë në Fakultetin e Bujqësisë të Universitetit të Prishtinës. Studimet pasuniversitare i kreu në Fakultetin e Bujqësisë të Universitetit të Zagrebit (1989), tezën e disertacionit e mbrojti në Fakultetin e Bujqësisë të Universitetit të Prishtinës (2002). Mori pjesë në përpilimin e projekteve nga lëmi i pemëtarisë dhe publikoi punime shkencore e profesionale dhe tekstin universitar “Fisnikërimi i pemëve dhe i hardhisë se rrushit”. Mori pjesë me kumtesa në tubime shkencore brenda dhe jashtë vendit. (Agim Zajmi).

SHALA Artor (1976-). Gazetar i sportit. Lindi në Prishtinë. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Prishtinë. Së fundi është duke i vazhduar studimet për gazetari. Profesionin e gazetarit të sportit e filloi në televizionin “Kohavision”, ku punoi në periudhën 2001-2010. Është kryeredaktor në “Supersport Kosova-digitalb”. (Edmond Thaçi)

SHALA Avdi (1942-). Shkrimtar, gazetar. Lindi në fshatin Kishnarekë të Drenasit, ku mori mësimet e para. Shkollën e mesme dhe studimet në Fakultetin Filozofik, në degën e gjuhës dhe të letërsisë shqipe i kreu në Prishtinë. Shumë vjet punoi si mësimdhënës në shkolla të ndryshme të Drenicës, të Obiliqit dhe të Mitrovicës. Një kohë më të gjatë punoi në gazetën “Kosova” të Elektroekonomisë së Kosovës. Është ndër shkrimtarët më prodhimtarë të letërsisë sonë për fëmijë. Krijimtaria e tij shquhet për afrinë me lexuesit e vegjël. Arrin t'i letrarizojë me sukses disa tema didaktike. Botoi përmbledhje me poezi, tregime dhe me pjesë teatrale që u realizuan në emisionet për fëmijë të radios, por edhe shumë romane. Është laureat i çmimit “Sofra poetike” dhe “Ymer Elshani”. Veprat e botuara: “Lulishtja” (1967), “Xum, xum, xum” (1973), “Vocërraku me tufën e rezeve” (1975), “Njeriu me kapelë të verdhë” (1984), “Viti i ikjeve” (1987), “Abetarja ime” (1988), “Djaloshi i padukshëm” (1989) “Kapedan Karameli” (2014) etj. (Arif Demolli)

SHALA Bedri (1969-1998). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), dëshmor. Lindi në fshatin Gjergjicë të Drenasit. Më 1992 emigroi në Danimarkë dhe më pas në Holandë. Në mars të vitit 1998, përmes Shqipërisë, u kthye në Kosovë, në Jabllanicë të Dushkajës. Një kohë veprroi në kuadër të komandës të Zonës Operative të Dukagjinit, në Glllogjan, ku u ngarkua me stërvitjen e rekrutëve të rinj. U dallua në betejat e Baballoçit, Gramaçelit, Prilepit, Rastavicës etj. Në qershor kaloi në Zonën Operative të Drenicës, në Likoc, ku u mor me organizimin e luftës dhe furnizimin me armë. Mori pjesë në luftimet e zhvilluara në Gllarevë, grykë të Llapushnikut, Çirez, Prekaz, Llaushë, Likoc etj. Në muajin korrik, në krye të një grupi prej më se 600 vullnetarësh nga Drenica, u nis për në Shqipëri, për furnizim me armatim. Më 27 korrik, së bashku me Bekim Berishën, në krye të mbi 400 luftëtarëve hyjnë në zonën e Junikut, ku po zhvilloheshin luftime të rrepta. Që nga kjo ditë B. Shala me bashkëluftëtarë zhvilluan betejat të pandërprera me forcat ushtarako-police serbe në rajonin e Rekës së Keqe. Ra më 10 gusht 1998 në mbrojtje të Junikut. (Bedri Shala dhe Fetnete Ramosaj)

SHALA Blerim (1963-). Gazetar, politikan. Lindi në Prishtinë. Shkollën fillore dhe të mesmen i mbaroi në Prishtinë, studimet për filozofi-sociologji në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Në vitin 1987 nisi punën gazetar në të përjavshmen “Zëri i rinisë”, ndërsa gjatë viteve 1991-1992 ishte redaktor përgjegjës i kësaj reviste (me emrin “Zëri”) dhe gjatë viteve 1997-1999 kryeredaktor i saj. Nga fundi



BLERIM SHALA

i vitit 1999 e deri në vitin 2008 ishte botues i të përditshmes “Zëri”. Ka shkruar komente, vështrime, analiza, intervista, ese etj. Gjatë viteve të zhbërjes së Jugosllavisë ka bashkëpunuar me gazetën “Mladina” të Lubjanës. Në fillim të viteve ’90 u angazhua në lëvizjet politike në Kosovë, si njëri nga themeluesit e lëvizjes së të rinjve Parlamenti Rinor (1990) dhe më pas anëtar i Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut në Prishtinë, anëtar i G15, një grup i formuar më 1998 për bise-

dime me Beogradin, pastaj anëtar i delegacionit të shqiptarëve për bisedime në Rambuje dhe në Paris më 1999, koordinator i bisedimeve të Vjenës dhe pjesë e delegacionit të Kosovës në bisedimet e Brukselit për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë. Ishte nënkryetar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe deputet në Kuvendin e Kosovës. Është autor i disa librave publicistikë: “Kosova, gjak e lot” (1990), “Unë, Ramiz Alia” (bashkautor, 1992), “Dëshmi për Kosovën” (1995), “Krimi dhe indiferenca” (1997), “Vitet e Kosovës” (2000), “Lufta diplomatike për Kosovën” (2003) etj. (Zenun Çelaj)

SHALA Demush (1929-1988). Studiuues dhe mbledhës i folklorit. Lindi në fshatin Nakëll të Pejës. Kreu arsimin fillor në vendlindje, Normalen në Pejë, kurse studimet në Fakultetin Filozofik të Beogradit, në katedrën e albanologjisë (1956). Ishte mësimdhënës në shkollat e larta pedagogjike në Prishtinë dhe në Prizren. Ishte kryeredaktor i Entit të Botimeve të Teksteve Shkollore të RS të Serbisë - Reparti në Prishtinë, pastaj sekretar i Dhomës së Arsimit dhe të Kulturës të KSA të Kosovës etj. Është autor i një sërë publikimesh shkencore dhe i disa teksteve shkollore. Ka botuar vëllimet “Këngë popullore legjendare” dhe “Këngë popullore lirike” (1973), “Këngë popullore historike” (1973), “Anekdota popullore” (1981) etj. Vlerë të veçantë kanë studimet e tij “Mbi epikën tonë popullore historike” (1982) dhe “Rreth këngëve kreshnike shqiptare” (1985). Ishte bashkëpunëtor i jashtëm i Institutit Albanologjik të Prishtinës dhe mori pjesë me kumtesa shkencore në shumë konferenca e tubime të tjera për folklorin. (Vlorë Fetaj-Berisha)

SHALA Dom Pjetër (1785-1856). Prift katolik, argjipeshkëv i shekullit XVIII. Të dhënat për jetën e tij janë të pakta. Dihet se lindi në Janjevë dhe se një kohë studioi në Napoli, por për shkak të rrethanave të kohës, Napoleoni e shpërndau kolegjin dhe kështu ai u detyra të shkojë për t’i plotësuar studimet në Romë. Pas studimeve u kthye në dioqezë, ku punoi me shumë zell në veprimtari religjioze dhe shoqërore. U shugurua si ipeshkëv në Shkodër, më 1834 nga atë Benigno Albertini, ipeshkëv i Shkodrës, në praninë e Pjetër Gurakuqit dhe të Matej Bardhit, ndërsa në këtë pozitë e emëroi Gregori XVI në vitin 1833. Të dhënat e

pakta tregojnë se argjipeshkvi Shala iu paraqit Kongregatës për herë të fundit më 8 mars të vitit 1839 dhe se vdekja e tij ka ndodhur më 1856. (Ndue Ukaj)

SHALA E BAJGORËS. Krahinë etnogeografike në verilindje të Kosovës, në pjesët jugore të Kopaonikut. Shtrihet në pesë komuna (Mitrovicë, Vushtrri, Podujevë, Zveçan dhe Leposaviq, por pjesa më e madhe e saj, rreth 90%, përfshihet brenda komunës së Mitrovicës, në lindje nga rrjedhat e lumenjve Ibër dhe Sitnicë. Ka shtrirje veriperëndim-juglindje, nga lugina e lumit të Cerajës, në veriperëndim, deri te Cecelia, në juglindje; ndërsa në drejtimin perëndim-lindje nga lugina e poshtme e Ibrit dhe e Sitnicës deri te luginat e lumenjve Murgull dhe Llap. Relievi është krijuar si rezultat i lëvizjeve tektonike të terciarit, kur ndodh thyerja e masës së vjetër kontinentale dhe krijimi i maleve, kodrave dhe kodrinave, në të shumtën në formë të pllajave, prej nga ngrihen maje të vetmuara malore, të ndara mes veti me lugina të thella, të krijuara nga erozioni i lumenjve (lumi i Cerajës, Bistrica e Shalës, lumi i Trepçës, i Kaçanollit, i Qytezës, i Sllakofcit etj.). Luginat e lumenjve kryesisht kanë anë me pjerrtësi të buta, në disa sektorë në formë kanioni, duke i dhënë tipare të veçanta relievore, ku dominojnë forma të “buta” relievore të maleve e kodrave të mbuluara me formacione bimore të livadheve, kullotave dhe pyjeve. Në Shalën e Bajgorës gjenden rreth 52 vendbanime. Vendbanimet më të njohura janë: Bajgora, Kaçanolli, Vidishiçi, Bare, Tërstena etj. Banorët e kësaj zone më herët kanë qenë të punësuar kryesisht në minierat Trepçës. Struktura njëetnike, kryesisht shqiptare e popullatës që e banon këtë krahinë, e veçon atë si një tërësi etnogeografike më vete. (Bektesh Vidishiçi)

SHALA Ferat (1964-). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Lindi në fshatin Vuçak të komunës së Drenasit. Mbaroi studimet në Fakultetin e Xehetarisë dhe të Metalurgjisë në Mitrovicë. Nga viti 1981 bënte pjesë në lëvizjen ilegale të kohës. Ishte njëri nga organizatorët dhe mori pjesë në protestat e studentëve në Mitrovicë (1989) dhe në grevën e studentëve, në përkrahje të minatorëve (1988-1989). Më pas punoi në gjimnazin e Drenasit (1991-1993) dhe në shkollën e mesme profesionale po në Drenas. Kontaktet e para me UÇK-në i filloi që nga fillimi

i viteve '90, ndërsa angazhimet e para i mori nga viti 1993. Me bashkëthemelues të tjerë të UÇK-së mori pjesë në organizimin e celulave të para të kësaj ushtrie. Kishte detyra dhe përgjegjësi komanduese në shumë aksione dhe beteja. Ishte udhëheqës i njësiteve operative “Pëllumbi”. Nga dhjetori i vitit '89 kaloi në Shtabin e Përgjithshëm, në drejtorinë e shërbimit informativ. Pas luftës ushtroi funksione të ndryshme shtetërore. (Skënder Lutfiu)

SHALA Hafir (1960-1998). Mjek, pjesëmarrës i luftës për çlirimin e Kosovës. Lindi në Krajkovë të Drenasit. Kreu shkollën fillore në vendlindje, gjimnazin në Drenas, studimet në Fakultetin e Mjekësisë në Zagreb. Në nëntor 1985 u arrestua nga policia serbe për shkak të aktivitetit politik dhe u dënua me pesë vjet burg. Pas daljes nga burgu punoi në Shtëpinë e Shëndetit në Drenas. Gjatë viteve '90 ishte aktiv në aksionin për pajtimin e gjaqeve në Drenicë, në Dukagjin, në Shalë, në Llap dhe Karadak. Me shpërthimin e luftës u angazhua për organizimin e punkteve shëndetësore në zonat e luftës. Më 1998 hapi ambulancën në Drenas, përmes së cilës ndihmoi popullsinë dhe pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Më 10 prill 1998, derisa po udhëtonte për në Prishtinë, u arrestua nga një patrullë policore në udhëkryqin e Sllatinës së Fushë-Kosovës. Që nga ajo ditë nuk u gjend asnjë gjurmë dhe nuk u mor vesh asnjë lajm për fatin e tij. (Ruzhdi Jashari).

SHALA Kujtim (1964-). Futbollist, trajner. Lindi në Prizren ku edhe e nisi karrierën te skuadra e “Lirisë”. Pas dy edicioneve në ekipin e parë të “Lirisë”, iu bashkua për një vit “Partizanit” të Beogradit, më pas u kthye sërish në Kosovë te skuadra e “Prishtinës”, ku qëndroi për pesë vjet. Pas Prishtinës, K. Shala kaloi në Kroaci në vitin 1989, te “Dinamo” e Zagrebit dhe luajti për tri vjet, duke qenë njëri prej idhujve të tifozëve të “Dinamos”. Luajti edhe për përfaqësuesen e Kroacisë. Në vitin 1991 e vazhdoi karrierën në Francë, te skuadra “Stade Rennes” dhe më pas në Gjermani, ku luajti për disa ekipe, si “Stuttgarter Kickers”, “Fortuna Dusseldorf”, “Leipzig” etj. Në edicionin 2005-2006 Shala u emërua trajner i skuadrës së “Prishtinës”, kurse prej vitit 2014 punën e trajnerit e bën te skuadra gjermane e kategorisë së ulët “SVN Zweibrücken”. (Tahir Sopi)

SHALA Kujtim M. (1974-). Poet, studiues i letërsisë, profesor universiteti, anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Lindi në Loxhë të Pejës. U dok-



KUJTIM M. SHALA

torua në Prishtinë për prozën e Mitrush Kutelit (2002). Është profesor në departamentin e letërsisë shqipe (2010) të Fakultetit të Filologjisë të Universitetit të Prishtinës. Ka botuar veprat studimore: “Shenjat e tekstit” (1999), “Lasgushi i përjetshëm” (1999), “Poezia e Bilal Xhaferrit” (2001), “Vox-i i Anton Pashkut” (2002), “Shënimet e Fishtës” (2002), “Kujtesa e tekstit” (2003), “Letërsia e vjetër dhe e Mesjetës” (2004), “Fishta përballë Fishtës” (2004), “Vepra e vetmisë” (2005), “Miniatūra” (2005), “Pro/Classica” (2005), “Kuteli i pa/zbuluar” (2006), “Shekulli i letërsisë shqipe” (2006), “Expo - Letërsia shqipe në katër pamje” (2007), “Elipsa” (2007), “Rugova meditans - Kritika letrare e Ibrahim Rugovës” (2008), “Acta Albanica” (2009), “Prishtina letrare” (2011), “Rugova i letërsisë” (2012), “Prolepsa” (2011), “Poezia: gjeneza e poetika” (2012), “Portret semiologu në rini” (2013), “Analepsa” (2013), “Prishtina letrare: petit Paris” (2014), “Ernest Koliqi: Authentica et urbana” (2015). Libra poetikë: “Mërzi e zezë” (1998), “Bukuria e zemërimit” (1999), “Vjeshta e shpirtit” (2000), “Sagë” (2004), “Sendet” (2010), “Kujtimi i Zonjës n’zi” (2012). Është fitues i disa çmimeve letrare. Në vitin 2016 u zgjodh anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Ka kryer detyra me përgjegjësi në institucionet e Kosovës, përfshirë atë të ministrit të Kulturës dhe të zëvendëskryeministrit në Qeverinë e Republikës së Kosovës. (Zejnullah Rrahmani)

SHALA Luljeta (1977-1998). Luftëtare e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), dëshmore. Lindi në fshatin Krajkovë të Drenicës. Në pranverë të vitit 1998 u bashkohet radhëve të UÇK-së. Pas mbarimit të stërvitjeve ushtarake, u sistemua në njësitin vëzhgues “Guri 3” të Brigadës 113, njësit që vepronte në fshatrat Kozmaq, Baicë, Domanek, dhe Llapushnik. Fillimisht shërbeu në detyrën e polices ushtarake, kurse më vonë si luftëtare në pikat e

fronit. U shqua në luftimet e ashpra të 25 dhe 26 korrikut dhe në ofensivën e 25 dhe 27 shtatorit 1998 në zonën e Llapushnikut. Në nëntor të vitit 1998 iu bashkua radhëve të komandantit Mujë Krasniqi, për furnizim me armë dhe municione nga Shqipëria. Më 14 dhjetor, duke u kthyer nga Shqipëria, 143 ushtarë të UÇK-së te vendi Likenet e Hasit ra në pritë të forcave serbe. Në këtë betejë të ashpër ranë 35 luftëtarë të shquar të UÇK-së, në mesin e tyre dhe L. Shala. (Bedri Muhadri)

SHALA Lulzim (1960-). Gazetar i sportit. Lindi në Prishtinë, ku kreu shkollën fillore dhe të mesme. Shkrimin e parë nga fusha e gazetarisë sportive e botoi në vitin 1979 në shtojcën e sportit të së përditshmes “Rilindja”. Nga viti 1982-1990 punoi si gazetar në Radio-Prishtinë, ku ishte edhe moderator i emisionit “Pasdita argëtuese sportive”. Pas mbylljes së Radiotelevizionit të Prishtinës ishte redaktor i disa revistave periodike. Në periudhën 1997-1999 ishte gazetar i sportit i të përditshmes “Bujku” (“Rilindja”), më pas në gazetën e përditshme “Zëri” (1999-2011), ku ushtroi edhe detyrën e redaktorit të sportit. Punoi edhe si gazetar në të përditshmen sportive “Topi”. Nga dhjetori vitit 2011 i rikthehet radiogazetarisë në Radio-Kosovë. Një kohë ishte anëtar dhe zëdhënës i Komitetit Olimpik të Kosovës. (Besim Kajtazi)

SHALA Mentor (1975-). Gazetar. Lindi në Prishtinë, ku kreu shkollën fillore dhe të mesme. Studimet për gazetari i kreu po në Prishtinë. Kreu edukim profesional në fushën e menaxhimit në Universitetin e Kalifornisë në Los Anxhelos dhe në Universitetin “Nevara” në Nju-Jork. Punën e gazetarit e filloi në Institutin për Luftë dhe Paqe (IWPR), më pas si gazetar dhe redaktor në gazetën e përditshme “Epoka e re”. Prej vitit 2000 punon në Radiotelevizionin e Kosovës (RTK), në fillim gazetar, redaktor, redaktor përgjegjës, zëvendësdrejtor dhe drejtor. Ka botuar shkrime autoriale publicistike në gazetën e përjavshme “Java”. Është autor i shumë emisioneve televizive për integritet europiane në RTK dhe i emisioneve debatusë në fushata zgjedhore. Si drejtor i televizionit kontribuoi në themelimin e katër kanaleve televizive në RTK-së. Në vitin 2013 u zgjodh drejtor i përgjithshëm i Radiotelevizionit të Kosovës. (Artan Krasniqi)

SHALA Meribane (1931-1956). Aktore. Lindi në Vushtrri. Ishte njëra ndër aktoret e para të skenës teatrale në Kosovë. Në Teatrin Popullor Krahinor u angazhua nga viti 1948. Si aktore përgjatë viteve '50 interpretoi shumë role, ndër të cilat më të shquara janë: Marica në shfaqjen "Personi i dyshimtë", Agafja Tihanova në "Martesa", pastaj Vidan te "Zhelanët". Me role të realizuara luajti edhe në shfaqjet: "Zjarri dhe hiri", "Sikur të isha djalë", "Hijet e rënda", "Tri botëna" (1953), "Zhorzh Dandeni" (1953), "Bota" (1953), "Besa" (1953), "Halit Gashi" (1955), "Koshtana" (1955), "Berberi i Seviljes" (1955). Vdiq në Prishtinë në moshën 25-vjeçare. (Arian Krasniqi)

SHALA Muhamet (1940-). Piktur. Lindi në Pejë. Kreu shkollimin fillor dhe të mesëm në Pejë, ndërsa Akademinë e Arteve Figurative në Beograd. Është anëtar Shoqatës së Artistëve Fi-



MUHAMET SHALA

gurativë të Kosovës nga viti 1974 dhe përmes saj realizoi një sërë prezantimesh të përbashkëta. Hapi disa ekspozita personale, si në Pejë më 1964, 1987 dhe 1993, pastaj në Tuzëll, Travnik etj. Mori pjesë edhe në disa ekspozita kolektive në Beograd (1975, 1981), Shkup (1983) Sombor (1983), pastaj në Çaçak, Karlovc, Dubrovnik, Sarajevë, Split, Tuzëll, Kanë, Nju-Jork, Tiranë etj. Është krijues i figuracionit kompozicional asamblazhist abstrakt. Kultivon frymën e enformelit. Përmes kolazheve e simboleve arti e krijimtaria e tij bëhen shfaqje të një realiteti estetik. Mori disa çmime për realizime të suksesshme në fushën e pikturës, si çmimin "Moshë Pijade" më 1964, çmimin e Sallonit VII Pranveror në Prishtinë, të Bienales së Vizatimit dhe çmime të tjera në Pejë dhe në Prishtinë. Nga viti 1974 ka ligjruar lëndën e vizatimit në Fakultetin e Arteve në Prishtinë. (Hajrush Fazliu)

SHALA Mujë (1950-). Mjek, pediatër, doktor i shkencave, profesor. Lindi më 15 shtator 1950 në Leçinë të Skënderajt. Shkollën fillore e kreu në vendlindje dhe Rakosh, ndërsa gjimnazin në Mitrovicë. U diplomua në Fakultetin e Mjekësisë në Beograd më 1976. Pas diplomimit u punësua në Shtëpinë e Shëndetit në Skënderaj. Më 1979

kaloi në klinikën e pediatriisë të Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë. Specializimin nga pediatria e mbaroi në Universitetin e Zagrebit më 1984. Në periudhën 1983-84 i vijon studimet pasdiplomike në Zagreb dhe më 1987 mbrojti tezën e magjistraturës me titull: "Veçoritë e morbiditetit dhe mortalitetit neonatal në Komunën e Prishtinës". Ndërsa, tezën e doktoratës me titull: "Lakoret e percentileve për të porsalindurit në Komunën e Prishtinës" e mbrojti më 1989. Në vitin 1986 u zgjodh asistent, më 1995 docent dhe në vitin 2004 mori titullin profesor nga lënda e pediatriisë në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. Më 1999 u emërua drejtor i kësaj klinike. Ka marrë pjesë në shumë simpoziume e kongrese dhe ka publikuar një sërë punimesh shkencore si autor dhe bashkautor. Jeton në Prishtinë. (Xhavit Bicaj)

SHALA Murtez Rexhep (1958-). Studiuës, prozator, mësimdhënës universitar. Lindi në fshatin Trudë të komunës së Prishtinës. Kreu shkollimin fillor në vendlindje, ndërsa atë të



MURTEZ REXHEP SHALA

mesëm në Prishtinë. Mbaroi studimet për letërsi dhe gjuhë shqipe në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës (1981). Një kohë punoi si gazetar në rubrikën e kulturës të gazetës "Rilindja", pastaj u zgjodh asistent për lëndën teoria e letërsisë. Më pas kreu studimet pasuniversitare dhe mbrojti tezën e disertacionit të doktoratës për aspektet teorike të veprës së Anton Pashkut (2000). Më pas u zgjodh profesor i rregullt për një grup lëndësh nga fusha e teorive letrare. Disa nga librat e tij studimorë dhe nga fusha e teorive letrare janë: "Ex libris - moderna pashkianë" (2000), "Theory-komunikimi modern" (2001), "Notes - teoria e metakomunikimit" (2005), "Analiza - kognicioni dhe modelimi" (2010), "Metateza - teoria dhe praksi letrar" (2014) dhe libri dialogues "CD Libris-antidrama e autorit" (2001). R. Shala shkroi trilogjinë në prozë "Papa - global wor(l)d" (2002), "Opium - alter wor(l)d" (2009) dhe "Fama - real wor(l)d" (2012). (Agron Gashi)

SHALA Mustafa (1921-1988). Gazetar. Lindi në Brestovc të komunës së Rahovecit. Shkollën

fillore e kreu në Prizren, kurse Medresenë e Madhe në Shkup. Në Beograd studioi për gjuhë frënge dhe italiane, por u detyrua t'i ndërprejë ato me fillimin e Luftës së Dytë Botërore. Pas kthimit në Prizren u mor me botimin e gazetës ilegale “Zani i rinisë”, për çka u kap dhe u dënua me vdekje, por i shpëtoi ekzekutimit pas hapjes së burgut të Prizrenit në nëntorin e vitit 1945. Që nga viti 1946 filloi të punojë në gazetën “Rilindja” në Prishtinë. Aty punoi për një kohë të gjatë si redaktor e një kohë si kryeredaktor i saj. Dha kontribut të çmuar në ngritjen e brezave të rinj të gazetarëve profesionistë në Kosovë. (Nehat Islami)

SHALA Sanije (1934-1997). Këngëtare dhe folëse e Radio Prishtinës. Lindi në Drenoc të Rahovecit. Ishte këngëtare e njohur e muzikës së lehtë, e një sërë realizimesh që ende ruhen të regjistruara në fonotekën e Radio Kosovës. Në Radio Prishtinë, si njëra ndër spikeret e para, filloi punë në vitin 1959 dhe punoi deri në mbyllje të këtij institucioni në fillim të viteve '90. Ishte lexuese e rregullt e lajmeve në këtë radio dhe e emisioneve të tjera radiofonike. (Nehat Islami)

SHALA Shaban (1933-1963). Mësues, veprimtar i lëvizjes ilegale, i burgosur politik. Lindi në Letanc të Podujevës. Shkollimin fillore e kreu në vendlindje, ndërsa shkollën e mesme në Prishtinë. Punoi si mësues në disa fshatra të Llapit e Gallapit, të Kamenicës dhe më pas të Tetovës. Në vitin 1949 anëtarësohet në Lëvizjen Nacional-Demokratike Shqiptare (LNDSH). Meqë aktiviteti i tij bie në sy të organeve të shtetit, bashkë me disa veprimtarë të tjerë përpiqet të largohet nga vendi, por në kufirin jugosllavo-austriak arrestohen. Për një vit mbahet në burgun e Prishtinës, bashkë me anëtarë të tjerë të LNDH-së të anës së Llapit. Pas vuajtjes së dënimit, shtrihet në spital, për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore. Më pas, përmes Metush Krasniqit vihet në kontakt me veprimtarë të tjerë nga e gjithë Kosova. Në muajin shkurt të vitit 1956 burgoset për herën e dytë, por lirohet pas disa muajsh. Gjatë viteve 1960-1961 merr pjesë në aktivitetet për ngritjen e flamurit kombëtar për festën e 28 Nëntorit. Në shtator të vitit 1962 burgoset për herë të tretë dhe dënohet me dy vjet burg. Vdiq në burg nga torturat, një ditë para se t'i kalonte afati i dënimit. (Arbër Salihu)

SHALA Shaban (1958-2012). Veprimtar, luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Lindi në fshatin Negroc të Drenasit. Pasi kreu shkollën e mesme në Klinë dhe Kijevë, mba-



SHABAN SHALA

roi Fakultetin Juridik në Universitetin e Prishtinës. Që nga shkolla e mesme veproi në organizatat ilegale që luftonin për çlirimin e Kosovës. Në vitin 1985 organizoi mbledhjen për bashkimin e organizatave ilegale të Kosovës.

Po atë vit u arrestua së bashku me 56 bashkëveprimtarë të tjerë dhe u dënua me 7 vjet heqje lirie. Në korrik të vitit 1991 u lirua nga burgu dhe po atë vit iu bashkua grupit të armatosur të Adem dhe Hamëz Jasharit. Më 1993 iu bashkua UÇK-së dhe në Zonën Operative të Drenicës u emërua ndihmëskomandant për moral, ndërsa me formimin e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së u emërua përgjegjës i drejtorisë për informim (1998). Gjatë luftës ndihmoi Radion “Kosova e lirë” dhe Agjencinë “Kosovapress”. Mori pjesë në shumë beteja dhe luftëra, si në betejën e grykës së Llapushnikut, të Bardhit të Madh, të Likocit, të Rezallës etj. Gjithashtu dha kontribut të rëndësishëm në hapjen e shkollës së parë ushtarake “Hamëz Jashari” në Likoc, për përgatitjen e oficerëve udhëheqës të UÇK-së. Pas çlirimit u inkuadrua në Trupat Mbrotjtëse të Kosovës. Vdiq nga një sëmundjeje e rëndë më 5 janar 2012. (Ali Uka)

SHALA Vjosa (1977-). Aktore, gazetare. Lindi në Mitrovicë. Përfundoi studimet për aktrim në Akademinë e Arteve në Universitetin e Prishtinës. Studioi edhe për gazetari. Si aktore ishte aktive në shumë shfaqje studentore në Teatrin “Dodona”, ndërsa në Teatrin Kombëtar luajti në shfaqjet “Moulin rouge” në regji të J. Budimës. Një kohë ishte edhe menaxhere e këtij teatri. Më 2010 luajti në shfaqjen “E kaluara takon të ardhmen” në regji të B. Berishës, pastaj “Të zhvendosura përbrenda” në regji të E. Hess-it (2012), “Monologët e vagjinës” (2013) etj. Luajti edhe në filmin artistik të metrazhit të gjatë “Ama dorën” të I. Sjarinës (2008). Pos si aktore, punoi si gazetare-producente në Radio “Urban FM”, pastaj në “Kohavizion”. Së fundi, si “drama therapist” punoi në Londër, në “Camden’s People Theatre”. (Jeton Budima)

SHALA Xheladin (1949-). Historian. Lindi në Mushtisht të Suharekës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, gjimnazin në Prizren, ndërsa studimet për histori në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës (1974). Nga viti 1977 punoi në Institutin Albanologjik, në sektorin e historisë. Më 1979 kreu studimet pasuniversitare, ndërsa në vitin 1986 mbrojti tezën e disertacionit të doktoratës për marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave në periudhën 1918-1924. Kreu detyra me përgjegjësi në organet drejtuese të Institutit. Në periudhën 1978-1985 ishte sekretar i redaksisë së revistës “Gjurmime albanologjike - Seria e shkencave historike”, ndërsa nga viti 1986 e deri më 2013 ishte kryeredaktor i serisë së shkencave historike të kësaj reviste. Botoi një sërë punimesh shkencore në revista të ndryshme dhe mori pjesë në tryeza, tribuna, simpoziume dhe konferenca shkencore të organizuara në Kosovë dhe jashtë saj. Ka botuar një sërë veprash monografike nga fusha e historisë, si: “Marrëdhëniet shqiptaro-serbe 1912-1918” (1989), “Çështja shqiptare dhe diplomacia serbe 1912-1913” (2006), “Ngjarje dhe personalitete historike” (2009), “Pushtimi i Kosovës nga Serbia dhe Mali i Zi 1912-1915” (2012), “Hasan Prishtina - vështrim i shkurtër atdhetarie” (2014), “Kontribute për 100-vjetorin e Pavarësisë” (2015) etj. (Lush Culaj)

SHAMBRA Mateo (Sciambra) (1914-1967). Gjuhëtar, teolog arbëresh. Lindi në fshatin arbëresh Kontesa Entelina të Sicilisë, në Itali. Ndoqi mësimet të gramatikës në seminarin pontifik në Grottaferatë dhe më pas në kolegjin pontifik grek në Romë. U diplomua më 1952 dhe ishte asistent i Atë Gjuzepe Valentinit në lëndën e gjuhës shqipe në Universitetin e Palermos. Më 1938 u caktua prift në Horën Arbëreshe në Sicili. Iu përkushtua jo vetëm gjuhës së folur arbëreshe, por edhe gjuhës së sotme shqipe. Pati rastin ta shohë letrën e Kazazit, që ruhet në Bibliotekën Mbretërore të Kopenhagës në fondin “Albanask Samling”. Sipas përshkrimeve të Shambres, dokumenti që ruhej në Seminarin Arbëresh s’ishte gjë veçse një kopje e origjinalit, së cilës i mungonte fleta e dytë, që përmbante dy fragmente të kopjuara nga “Meshari” i Buzukut. La disa vepra të botuara në një monografi, të cilat kanë të bëjnë kryesisht me çështjen arbëreshe dhe me veprat e shkrimtarëve arbëreshë. Ndër veprat më të

rëndësishme janë: “Doktrina e krështerë” e Lekë Matrëngës - riprodhim, transkriptim, komentim, Vatikan, 1964; “Statusi aktual i shqipes së folur në Sicili” (1964). (Pranvera Osmani)

SHAQIRI I. Gazmend (1936-). Mjek, kirurg i përgjithshëm, kirurg vaskular, profesor universiteti. Lindi në Shkodër. Shollën fillore dhe gjimnazin i kreu në Prishtinë, Fakultetin



GAZMEND I.
SHAQIRI

e Mjekësisë në Beograd, specializimin për kirurgji të përgjithshme në Akademinë Mjekësore-Ushtarake në Beograd (1969), ndërsa specializimin për kirurgji kardiovaskulare në UKECH të Pragës (1970-1972) dhe Texas Heart Institute të Houston-it, SHBA (1987). Është themelues i kirurgjisë vaskulare në Kosovë. Me hapjen e Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë u zgjodh ligjërues (1969), prodekan (1973-1975) dhe dekan i këtij fakulteti (1976-1979). Pas mbrojtjes së doktoratës nga lëmi i kirurgjisë së enëve të gjakut (1974), merr thirrjen docent, më vonë profesor inordinar (1977) dhe profesor ordinar (1983) i lëndës së kirurgjisë. Në periudhën 1987 - 1990 ishte udhëheqës i Klinikës së Kirurgjisë dhe të Ortopedisë të Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë. Pas luftës, më 1999 u kthye në Kosovë dhe udhëhoqi shërbimin e kirurgjisë vaskulare ku kreu me sukses shumë operacione të ndërlikuara kirurgjike. Qe mësimdhënës i shumë kuadrove të mjekësisë në Kosovë. Botoi mbi 197 punime shkencore. Mori pjesë në tubime të shumta shkencore në vend dhe jashtë tij. Botoi disa libra dhe monografi nga lëmi i kirurgjisë vaskulare dhe asaj të përgjithshme: “Sëmundjet e arterieve” (1989), “Kirurgjia e zemrës dhe aortës” (1994), “Doracakët medicinalë në praktikën ditore” (1996) “Kirurgjia urgjente-lëndimet” (1999). “Kirurgjia urgjente - sëmundjet akute” (2001) dhe në fund të vitit 2001, “Kirurgjia urgjente - sëmundjet akute II”(2001). “Monografia e ndërhyrjeve kirurgjike”(2004). Jeton në Prishtinë. (Avdyl Krasniqi)

SHAQIRI Gjerdan (1991-). Futbollist. Lindi në fshatin Zhegër të Gjilanit. Në vitin 1992 së bashku me familjen e tij migroi në Zvicër.

Nisi karrierën të “SV Augst”, para se të kalonte te “Baseli” dhe të shpallej lojtari më i mirë për ekipet U-15. Për dy vjet luajti me ekipin e dytë të “Baselit”, pastaj i bashkohet ekipit të parë. Për “Baselin” luajti tri edicione (2009-2012) dhe fitoi tri herë titullin e kampionit të Zvicrës dhe dy herë Kupën. Dy herë u shpall edhe futbollisti më i mirë i vitit në Zvicër. Në vitin 2012 kaloi te skuadra “Bajern” (Bayer) e Munihut, me të cilin fitoi trofeun e Ligës së Kampionëve dhe dy herë titullin e kampionit të Gjermanisë dhe Kupën e Gjermanisë. Gjithashtu fitoi edhe Superkupën e Gjermanisë, Superkupën e Europës dhe botërorin e klubeve. Ndërkohë, në vitin 2010 u ftua nga përfaqësuesja e Zvicrës. Deri tani me Zvicrën mori pjesë në dy kampionate botërore, ndërsa në botërorin “Brazili 2014” dy herë fitoi epitetin e lojtarit më të mirë të ndeshjes. Në Brazil shënoi tregolësh kundër Hondurasit dhe dërgoi ekipin zvicëran deri në 1/8 e finales. Në janar të vitit 2015, Shaqiri kaloi te “Interi” i Milanos, me të cilin ka kontratë deri në vitin 2019. Në janar të vitit 2015 Shaqiri kaloi te “Interi” i Milanos, ndërsa po këtë vit u huazua te skuadra e njohur angleze “Stoke City”. (Tahir Sopi)

SHAQIRI Hisni (1949-). Veprimtar politik, luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare (UÇK). Lindi në fshatin Hotël, komuna e Likovës (Kumanovë) të Maqedonisë. Kreu Shkollën Normale në Shkup, ndërsa studimet për histori në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Punoi si mësimdhënës në fshatra të Kumanovës dhe Gjilanit. Pas demonstratave të vitit 1981 u përjashtua nga puna dhe iu mor e drejta për të punuar në arsim në Maqedoni. Më 1991 u zgjodh deputet i Kuvendit të Maqedonisë nga radhët e Partisë për Prosperitet Demokratik. Ishte deputet edhe në dy legjislaturat vijuese (1994-1998 dhe 1998-2002), së fundi nga radhët e Partisë Demokratike Shqiptare. Në mars të vitit 2001, pas shpërthimit të luftës në Maqedoni, braktisi postin e deputetit në Kuvendin e Maqedonisë dhe iu bashkua radhëve të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare (UÇK). Veprroi në kuadër të Brigadës 113 “Komandant Kumanova”. U zgjodh anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së. Në vitet 2002-2006 ishte deputet i Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI), ndërsa më vonë u zgjodh nënkryetar i Kuvendit të Maqedonisë. Në fund të vitit 2005 dha dorëheqje si nënkryetar i Kuvendit dhe u

largua nga BDI-ja, duke vepruar si deputet i pavarur. (Fehari Ramadani)

SHAQIRI Ilir (1960-). Këngëtar, kompozitor. Lindi në Burojë të Drenicës. Shkollën fillore e kreu në Turiçec, të mesmen në Prizren, studimet për gjuhë e letërsi shqipe në Prizren dhe në



ILIR SHAQIRI

Prishtinë. Kreu edhe studimet pasuniversitare në fushën e letërsisë. Krijoi mbi 600 këngë të muzikës së lehtë, popullore dhe për fëmijë. Është autor i muzikës në një sërë filmash dokumentarë dhe shfaqjesh teatrore. Botoi 34 albume muzikore dhe 4 videoalbume me këngë. Në 100-vjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë botoi albumin me 100 këngë të përzgjedhura, pastaj studimin “Estetika dhe semiotika në krijimtarinë artistike të nënës” (2014) dhe romanin “Tan Temali” (2014). Më 1998 mbajti një sërë koncertesh nëpër Europë, në përkrahje të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Më 1999 ishte anëtar i trupës artistike-ushtarake, themeluar nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së. U vlerësua brenda e jashtë vendit me çmime të jurive dhe të publikut në festivale dhe prezentime të ndryshme publike. (Xhevdet Gashi)

SHAQIRI Korab (1986-). Kompozitor dhe kantautor. Është autor veprash i muzikës klasike, asaj argëtuese, për pionierë dhe të muzikës për film. Lindi në Prishtinë, ku kreu Shkollën e Mesme të Muzikës, drejtimi i solokëndimit. Akademinë e Arteve të Bukura e kreu në Tiranë, dega e kompozimit (prof. H. Zacharian), ku kreu dhe studimet master (A. Peçi). Ka kompozuar vepra gjinësh të ndryshme: pjesë për piano, tema me variacione për piano, vepra korale dhe veprat orkestrale: Suitë për orkestër, Simfonia; muzikore-skenike: Baleti me libretto, inspiruar nga historia e mbretëreshës Teuta; muzikën për shfaqjen “Romeo e Xhuljeta”, “Mbreti gjumash dhe biri i tij” (shfaqje për fëmijë), si dhe një numri këngësh argëtuese dhe për fëmijë. Kompozimet e tij kanë fituar disa çmime në festivale. (Kristina Palokaj-Përkola)

SHAQIRI Mustafë (1967-). Veprimtar i lëvizjes kombëtare. Lindi në fshatin Rahovicë

të Preshevës. Në vitin 1993 u inkuadrua në Lëvizjen Popullore të Kosovës (LPK), në këshillin e rrethit të Preshevës. Në vitin 1997, kur ky këshill i LPK-së u shndërrua në njësit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), u bë pjesë e këtij njësi. Pas përfundimit të luftës së UÇK-së, u angazhua në organizimin e celulave ushtarake, nga të cilat më vonë do të formohet Ushtria Çlirimtare për Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë (UÇPMB). Në prill të vitit 2000 u emërua komandant i Zonës Operative të Preshevës i UÇPMB-së, ndërsa më pas zëvendëskomandant i Shtabit të Përgjithshëm të UÇPMB-së. Mori pjesë në ekipin negociator në bisedime me Serbinë, si përfaqësues i krahut luftarak të palës shqiptare. (Fehari Ramadani)

SHAQIRI Rizah (1961-). Shkrimtar, gazetar, përkthyes. Lindi në Brainë të Podujevës, ku kreu shkollën fillore. Kreu Shkollën e Mesme të Mjekësisë dhe studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Prishtinë. Punoi si gazetar në Radio-Prishtinë. Pas përzënies nga puna të gazetarëve shqiptarë nga pushteti serb, u detyrua të emigronte në Suedi. Atje u angazhua në procesin e mësimin plotësues në gjuhën shqipe. Është aktiv në jetën kulturore të shqiptarëve të shpërngulur në Suedi. Është bashkautor i teksteve shkollore për mësimin plotësues në gjuhën shqipe në diasporë. Merret edhe me përkthime letrare nga gjuha suedeze. Shkruan kryesisht për fëmijë, poezi dhe prozë. Botoi një numër përmbledhjesh me poezi, përmbledhjesh me tregime, romane, ilustracione: “Zemër krejt dashuri” (1990), “Hëna e di lojën” (1990), “Merimanga e dritës” (1991), “Shëngjergjat e mi” (1993), “Kur buzëqeshin lulet” (1998) etj. Jeton në Malmo të Suedisë. (Arif Demolli)

SHAQIRI Sabri (1969). Skulptor. Lindi në Vrapçiq të Gjilanit. Kreu Fakultetin e Arteve Figurative, degën e skulpturës, në Prishtinë (1994). Është pjesëmarrës i disa ekspozitave kolektive të organizuara nga Shoqata e Artistëve Figurativë të Kosovës (SHAFK) brenda dhe jashtë vendit. Është anëtar i SHAFK-ut nga viti 1994. Gjatë viteve '90 ka organizuar ekspozita personale në Kafe-galerinë “Koha” dhe “Hani i 2 Robertëve” në Prishtinë, pastaj më 2015 në Muzeun Historik të Tiranës, ndërsa mori pjesë edhe në disa ekspozita kolektive të organizuara nga SHAFK-u apo në kuadër të manifestimit

“Flaka e Janarit” në Gjilan. Është fitues i disa çmimeve për veprat skulpturale. (Luan Mulliqi)

SHAQIRI Sylejman (1956-). Gazetar. Lindi në Ferizaj. Shkollën fillore dhe gjimnazin i mbaroi në vendlindje, kurse Fakultetin Juridik në Prishtinë. Punën e gazetarit e filloi më 1982, më pas si redaktor dhe në vitet 1984-1988 kryeredaktor dhe drejtor i Radio Ferizajt. Më 1988 filloi punën në Radiotelevizionin e Prishtinës (RTP), një herë gazetar dhe më pas redaktor përgjegjës i programit informativ të RTP-së. Gjatë viteve 1991-1992 ishte gazetar dhe redaktor në redaksinë e lajmeve në gjuhën shqipe të Radio-Kroacisë në Zagreb dhe më pas në redaksinë e lajmeve për Kosovën në Televizionin Shqiptar. Më vonë punoi korrespondent i gazetës “Koha ditore” nga Ferizaj dhe redaktor në gazetën “Kosova sot”. Pas luftës një kohë ishte kryeredaktor i radios lokale “Tema” në Ferizaj, ndërsa në vitin 2000 kthehet në Radiotelevizionin e Kosovës (RTK), njëherë si autor i emisioneve debatuuese politike dhe më vonë redaktor i emisioneve, drejtor i Radio Kosovës, kryeredaktor përgjegjës dhe producent ekzekutiv për programet e minoriteteve. Më pas, deri në mars të vitit 2007, ishte kryeredaktor i televizionit, ndërsa nga viti 2010, për një mandat, ishte drejtor i përgjithshëm i RTK-së. (Shaqir Foniqi)

SHAQIRI Shaqir (1947-). Përkthyes, studiues, mësimdhënës universiteti. Lindi në Pejë, ku mbaroi shkollën fillore dhe gjimnazin. Kreu studimet për gjuhë dhe letërsi angleze e amerikane në Fakultetin Filozofik të Prishtinës, ndërsa pas diplomimit qëndroi një vit në Londër për studime gjuhësore. Disa vjet punoi si mësimdhënës i gjuhës dhe letërsisë angleze në Shkollën Normale të Gjakovës dhe në gjimnazin e Prishtinës. Në vitin 1972 u zgjodh asistent dhe më vonë ligjërues në degën e gjuhës edhe letërsisë angleze të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Në vitin 1977 kreu studimet pasuniversitare ndërsa në vitin 1980 mbrojtë tezën e doktoratës “Edit Durhamit dhe shqiptarët”. Ka përkthyer tregime të E. Heminguejit, ese të G. Grinit dhe poezi të autorëve të ndryshëm të letërsisë angleze. Ka përzgjedhur dhe përkthyer gjithashtu në libra të veçantë poetët e romantizmit anglez: Xh. G. Bajron, P. B. Shell, J. Kits, U. Uordsuorth dhe S.T. Kollerixh. Nga gjuha shqipe në gjuhën angleze

ka përkthyer antologjinë e poezisë shqipe të poetëve të Kosovës, “Degë e pikëlluar” (“The Sad Branch”). Në vitin 1981 u burgos për arsye politike, ndërsa në fillim të viteve '90 u përfshi në lëvizjet politike të kohës. Më pas emigroi në Suedi. (Hasan Hasani)

SHAQIRI Shaqir (1964-). Veprimtar i çështjes kombëtare. Lindi në fshatin Depcë, komuna e Preshevës. Kreu shkollën fillore në Preshevë, të mesmen në Ferizaj, ndërsa studimet për gjeografi në Universitetin e Prishtinës. Në vitin 1982, në moshën 17- vjeçare u arrestua si themelues dhe udhëheqës i një organizate ilegale dhe u dënua me 6 vjet burg. Pas daljes nga burgu, vazhdoi aktivitetin në Lëvizjen Popullore për Republikën e Kosovës (LPRK). Në prill-korrik 1990 inicioi themelimin e subjektit të parë politik në Luginën e Preshevës, Shoqatën e Pavarur Demokratike (më vonë Partinë Demokratike Shqiptare). Më 1997, kur struktura e këshillit të rrethit të LPK-së u shndërruan në njësite ushtarake, ai u bë pjesë e këtyre njësiteve dhe udhëheqës i tyre. Pas përfundimit të luftës në Kosovë u përfshi në Trupat Mbrojtëse të Kosovës. Më 23 mars 2000 mori pjesë në themelimin e Këshillit Politik për Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc. (Fehari Ramadani)

SHAQIRI Ymer (1953-). Grafist. Lindi në fshatin Sfeçël të Podujevës. Kreu Akademinë e Arteve, drejtimin e grafikës. Krijimtaria e tij mbështetet në motivet e arkitekturës orientale, me dyer e dritare të vjetra, të gravuara me ndjeshmëri kreative, të gjitha këto të realizuara në teknikën e akuatintës, me zotësi dhe bakërshkrimin, me strukturë të pasur dhe koloritin bardhë e zi. Organizoi një sërë ekspozitash personale, si: në Prishtinë, në Galerinë e Arteve të Kosovës (2008), pastaj në “Galeria BI-Z” në Kristiansand në Norvegji, në Lubjanë në “Galeria Feniks” (1989), në “Galeria Pilan” në Bernë të Zvicrës (1993) dhe në Galeria “Mira” po në këtë qytet (1995), pastaj në Mannheim të Gjermanisë (1999), në Augsburg (Galeria “Schroder”, 2000), në “Galeria Mannheim BGN” (2002), më 2003 në Berlin, pastaj në Hajderberg etj. Në vitin 2015 u prezantua sërish me ekspozitë në Galerinë e Arteve të Kosovës. Mori pjesë në shumë ekspozita kolektive në Kosovë, Gjermani etj., si në Binalet XVI, XVII, XVIII të Grafikës në

Lubjanë, në ekspozitën e grafikës në Katania, në “Trienniala Europiane” në Grado, në “Kunst” në Cyrih, “Arte” në Lisbonë, pastaj Çikago, Këln, Los Anxhelos etj. Jeton dhe vepron në Gjermani. (Fatmir Krypa)

SHARPING Rudolf (1947-). Politikan socialdemokrat gjerman, ish-ministër i Mbrojtjes i Gjermanisë në periudhën e krizës në Kosovë (1998-2002). Nga viti 1993 deri më 1995 ishte edhe kryetar i Partisë Socialdemokrate të Gjermanisë (SPD). Në korrik të vitit 2002 u largu nga detyra e ministrit të Mbrojtjes dhe pushoi aktivitetin politik. Bashkë me kancelarin Shreder dhe ministrin e Jashtëm Fisher u bënë sinonim i angazhimit ushtarak të Gjermanisë në fushatën ajrore të NATO-s kundër Jugosllavisë së mbetur në mars-qershor 1999. Ishte një nga politikanët gjermanë që bëri publike ekzistimin e planit sekret serb “Patkoi” për spastrimin etnik të Kosovës. Shkroi librin e memoareve kushtuar luftës së Kosovës: “S’duhet të shikojmë me mospërfillje - Lufta e Kosovës dhe Europa” (1999). Në vitin 2004 presidenti i Kosovës e nderoi me “Medaljen e Artë të Lirisë”, në shenjë mirënjohjeje për kontributin e dhënë për lirinë e Kosovës. (Sylë Ukshini)

SHARRËZA (TETANOSI). Tetanosi është sëmundje jongjitëse akute e rëndë që karakterizohet me shtangim të muskujve të trupit. Sharrëza shkaktohet nga Clostridium tetani, bakterie anaerobe që liron dy lloje të toksinës: tetanospazmina që prek fijet nervore dhe shkakton shtangim të muskujve si dhe tetanolizina që shkakton lizën e eritrociteve. Clostridium tetani në ambientin e jashtëm është në formë të sporeve dhe si e tillë rri me dekada. Me të hyrë në plagë të ndotura, forma sporogjene kalon në formë vegetative, e cila liron toksinën. Pas periudhës së inkubacionit prej 3-21 ditë, mesatarisht pas 14 ditësh fillojnë simptomat e sëmundjes. Prezente janë disa forma klinike të sëmundjes: lokale, të gjeneralizuara, gjinekologjike, puerperike dhe të porsalindurve. Pasi sëmundja është jongjitëse karakteristike janë rastet sporadike. Por, në rast të vërshimeve, luftërave, tërmeteve sëmundja mund të paraqitet në shkallë më të lartë. Trajtimi i sëmundjes bëhet me terapi mbështetëse: dhënia e imunoglobulinës, ventilimi artificial, trajtimi i spazmës së muskujve etj. Kurse parandalimi

bëhet me dhënien e vaksinës kundër sharrëzës sipas kalendarit të vaksinimit. Sëmundja është e pranishme në gjithë botën në formë sporadike. Problem në vete është sharrëza e të porsalindurit, që vjen si pasojë e prerjes së kërthizës me mjete johigjienike. Në Kosovë prej vitit 1945 e deri më 1970 janë regjistruar 1186 raste të sëmundjes, prej të cilëve 50% kishin vdekur ndërsa falë vaksinimit masiv që nga viti 1988-2000 janë regjistruar 40 raste të sharrëzës te të rritur dhe 34 raste te të porsalindurit me 7 vdekje. Pas vitit 2000 nuk është shënuar asnjë rast i sharrëzës te të porsalindurit. (Isme Humolli)

SHARRI. Shih: DRAGASHI.

SHARRI. Vargmal në jug të Kosovës, ka shtrirje prej 80 km gjatësi dhe 10-20 km gjerësi përgjatë kufiri Kosovë-Maqedoni, nga mali i Korabit në jugperëndim, deri te gryka e Kaçanikut në verilindje. Nga Sharri veçohen disa degë, të cilat formojnë male më vete: Koritniku (2,395 m), përgjatë kufirit me Shqipërinë, Cvileni (1.381 m), Oshlaku (2.212 m) dhe Mali i Nerodimës (1,721 m). Në aspektin litologjik, Sharri përbëhet nga shkëmbinj të ndryshëm të moshës paleozoike dhe mesozoike. Përhapje më të madhe kanë filitet, shistet argjilore të metamorfizuara, pastaj rreshpet e gjelbra, mermerët, dolomitët, kuarcitet, gëlqerorët e triasikut, granitet, granodioritet etj. Në aspektin strukturor-tektonik, Sharri paraqet një horst antiklinal ndërmjet luginës së Pollogut në juglindje (Maqedoni) dhe Rrafshit të Dukagjinit në veriperëndim, i ngritur në lartësinë e sotme nga lëvizjet e vjetra rrudhosëse (ngjeshëse) dhe ato të reja neotektonike e vertikale. Relievi i Sharrit është alpin dhe dallohet me shpate të thepisura, majat e mprehta, luginat e thella, ndërsa kurrizorja e tij përfaqëson një rrafshnaltë të penepenizuar, me lartësi 2,000-2,200 m, e sheshuar nga ciklet e vjetra të erozionit dhe e ngritur në lartësinë e sotme nga lëvizjet e mëvonshme tektonike të pliocen-kuaternarit. Mbi kurrizin e tij ngrihen maja malore me lartësi mesatare relative 300-500 m. Majat e larta janë Maja e Liqenit (Bistra), maja më e lartë e Sharrit (2,640 m), Luboteni (2,496 m), Livadhi (2,491 m), Maja e Zezë (2,584 m) etj. Relievi i Sharrit është përpunuar nga erozioni ujqor, akullnajor, krionival e karstik ose në disa raste edhe nga erozioni i kombinuar (poligjenetik).


Veprimtaria e fuqishme shkatërruese (eroduese) dhe akumuluese e akullnajave gjatë kohës së kuaternarit ka çuar në krijimin e një numri të madh formash të relievit akullnajor, siç janë: cirqet e shumta, luginat akullnajore, morenat etj. Format karstike kanë përhapje më të vogël, pasi shkëmbinj të karbonatikë janë më të kufizuar dhe përfaqësohen nga gropa, hinka, shkrepja, lugje karstike, humnera etj. Format karstike janë më të shumta në malin e Koritnikut. Klima e Sharrit është alpine. Dimri i ftohtë, me ngrica e borë në pjesën më të madhe të vitit (mbi 2,300 m), me verë të shkurtër, të freskët e të lagësht, me reshje mesatare vjetore prej 900-1,300 mm. Sharri ka resurse të mëdha ujore në formë lumenjsh, liqenesh dhe burimesh të ujërave nëntokësore. Lumenjtë kryesorë janë: Lepenci, Bistrica e Prizrenit, lumi i Plavës etj. Liqenet janë të shumta dhe me origjinë nga cirqet akullnajore. Gjenden në lartësi të mëdha mbi 2,000 m dhe në pjesën e Kosovës më të njohurit janë liqeni i Livadicës (Livadhiti) dhe i Jazhincës (Malfshatit). Burimet e ujërave nëntokësore janë të shumta dhe shpeshherë të fuqishme (gurra karstike). Sharri është i mbuluar dendur me bimësi. Deri në lartësi prej 1,000 m shtrihet dushku e gështenja, më lart ahu e halorët dhe në pjesët më të larta shtrihen zonat e pasura me livadhe e kullosa, ndërsa majat më të larta janë shkëmbore dhe të zhveshura nga bimësia. Në anën veriperëndimore të Malit Sharr është ndërtuar kompleksi unik rekreativo-turistik dhe i sporteve dimërore, qendra e skijimit "Brezovica". Në vitin 1986, një pjesë e konsiderueshme e Maleve të Sharrit, në sipërfaqe prej 39,000 ha, është shpallur Park Nacional "Mali Sharr", ndërsa në vitin 2013, me ligj është riemërtuar në Parku Nacional "Sharri" dhe është zgjeruar në sipërfaqe prej 56,439 ha. (Vahdet Pruthi)

SHASHEL (Šašel) Ana (1921-2001). Filologe klasike dhe bibliotekare. Lindi në Lubjanë (Slloveni), ku mori arsimimin bazë dhe kreu studimet për filologji klasike. Gjatë viteve 1948-1963 punoi si mësuese në Bohinjka Bistrica, Jesenicë, Ptuj, Maribor dhe Lubjanë. Më pas u punësua në Muzeun Kombëtar në Lubjanë dhe më vonë punoi si bibliotekare në Institutin Arkeologjik të Arteve. Mori pjesë në gërmimet arkeologjike në Bled dhe Ptuj si dhe punoi në arsim, kryesisht në modernizimin e mësimdhënies së gjuhës latine. Shkroi

tekstet “Fundamenta Latina I-III” dhe “SAXA loguuntur”, botoi artikuj për historinë sllovene në “Chronicle Journal”, “Enciklopedia e Jugosllavisë”, “Inxhinieria arkeologjike” dhe “Vestnik”. Botoi “Udhërrëfyes për Emonë” dhe në bashkautorësi me J. Shashel, botoi “Mbishkrime latine të Jugosllavisë MCMII dhe MCMXL” (1963), ku përfshihen monumentet epigrafike nga Kosova. (Arianit Buçinca)

SHASHEL (Šašel) Jaroslav (1924-1988). Arkeolog, historian i kohës së vjetër, epigrafist, profesor universitar. Lindi në Lubjanë (Slloveni) dhe studimet e larta i kreu në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Lubjanës, ku doktoroi për arkeologji dhe histori të kohës së vjetër (1969). Nga viti 1951 punoi si asistent në departamentin e arkeologjisë të Universitetit të Lubjanës, ku më pas mori titullin profesor. Studimet pasuniversitare i kreu në Universitetin e Gracit (Austri) dhe në Athinë (Greqi). Dy vjet i kaloi në Institutin për Studime të Avancuara në Princeton (SHBA). Ishte anëtar i rregullt i Institutit Arkeologjik Gjerman, anëtar i jashtëm i Qendrës për Epigrafi dhe Numizmatikë në Beograd, anëtar i Institutit Arkeologjik të Austrisë, anëtar i Qendrës për Hulumtime Shkencore të Akademisë Sllovene të Shkencave dhe të Arteve etj. Është autor i shumë monografive dhe hulumtimeve shkencore: “Ad Pirum” (1971-1973), “Harta arkeologjike e Sllovenisë” (1969) etj. Në bashkautorësi me A. Shashel botoi “Mbishkrime latine të Jugosllavisë MCMII dhe MCMXL” (1963), ku përfshihen monumentet epigrafike nga Kosova. (Arianit Buçinca)

SHATRI Bajram (1946-). Pedagog, veprimtar i arsimit, botues. Lindi në fshatin Tomoc, komuna e Istogut, shkollën fillore e kreu në Gurakoc, gjimnazin në Mitrovicë, ndërsa stu-



BAJRAM SHATRI

dimet në degën e pedagogjisë të Fakultetit Filozofik në Prishtinë. Fillimisht punoi si mësues në Zallç (Istog) dhe në Sibofc (Obiliq), pastaj mësimdhënës në shkollën ekonomike dhe në Normalen e Mitrovicës. Më pas ishte pedagog në shkollën fillore “Emin Duraku” në Prishtinë, si dhe koordinatort në BVI-në Krahinore të Ar-

simit dhe Edukimit. Ishte njëri nga themeluesit dhe sekretar i Këshillit për Vetëfinancimin e Arsimit (1991), si dhe sekretar i Këshillit të Financimit të Kosovës (1992-1995). Ndërkohë, punoi si këshilltar në Entin Pedagogjik të Kosovës, në trupën ministrore të arsimit në Kosovë dhe ishte anëtar i senatit të Universitetit të Prishtinës. Prej vitit 1997 punon në Entin e Teksteve dhe të Mjeteve Mësimore (Shtëpia Botuese “Libri shkollor”), fillimisht si kryeredaktor, ndërsa që nga viti 1999 drejtor i saj. Është autor ose bashkautor i një sërë tekstesh mësimore. Fusha e interesimit të tij është historia e arsimit në Kosovë. Është edhe autor i disa veprave nga fusha e historisë së arsimit në Kosovë: “Arsimi fillor në Kosovë në shekullin XX” (2006), “Arsimi shqip në Kosovë 1990-1999” (2010), dhe bashkautor: “Shifra dhe fakte për arsimin e Kosovës” (2000), “Universiteti i Prishtinës 1970-2005” (2005), “Këshilli Qëndror i Financimit i Kosovës” (2007) etj. (Hajrullah Koliqi)

SHATRI Muhamet (1946-). Historian. Lindi në Tomoc të Istogut. Shkollën fillore e kreu në Gurrakoc, gjimnazin në Pejë, ndërsa studimet themelore, degën e historisë, i kreu në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës (UP) (1972). Studimet pasuniversitare i kreu në Prishtinë dhe doktoraturën e mbrojti po në UP (1982). Në periudhën 1965-1977 punoi në arsim, ndërsa në vitet 1978-1989 punoi në Institutin e Historisë në Prishtinë. Më pas emigroi në Suedi, ku u përfshi në organizimet politike dhe kulturore të mërgimtarëve të Kosovës në shtetet skandinave. Më 1999 u kthye në Kosovë, në Institutin e Historisë. Ishte sekretar shkencor i Institutit të Historisë (2003-2007) dhe më pas kryetar i shoqatës së intelektualëve “Trojet e Arbrit” (2004-2015) dhe redaktor i Edicionit të saj “E djathta shqiptare në mbrojtje të Shqipërisë Etnike”. Është autor i monografive “Lëvizja Nacionalçlirimtare në Prizren dhe rrethinë 1941-1945”, “Kosova në Luftën e Dytë Botërore 1941-1945”, “Jeta dhe veprimtaria atdhetare e Ibrahim Grincës”, si edhe i disa vëllimeve dokumentesh franceze, ruse e britanike për Shqipërinë dhe shqiptarët. Botoi shumë artikuj e studime në revista të ndryshme shkencore. (Jusuf Bajraktari)

SHÇERBIN Stepanoviç Grigori (1868-1903). Diplomati rus, me origjinë ukrainase. Në vitin 1889 nisi shërbimin diplomatik në Stamboll

dhe pastaj në Shkup. Në vitin 1897 u emërua zëvendëskonsull në Shkodër, duke mbajtur njëkohësisht postin e ministrit rezident në Cetinë. Pas hapjes së Konsullatës Ruse në Mitrovicë më 7 maj 1902, G. Shçerbin emërohet konsull në këtë qytet dhe e merr detyrën në janar të vitit 1903. Shqiptarët e pritën me zemërim ardhjen e tij dhe, për pasojë, pas pak javësh, ai u vra prej tyre. Historiografia ruse dhe serbe e paraqesin vrasjen e tij si pasojë të një komploti të nxitur dhe të organizuar nga Austro-Hungaria. Por është e ditur se në kohën e mbërritjes së tij në Mitrovicë, shqiptarët ishin përfshirë në një lëvizje kundër të ashtuquajturave reforma në vilajetet e banuara prej tyre, të cilat synonin, midis të tjerash, edhe çarmatimin e popullsisë civile. Pasi morën vëmendje, kryengritësit shqiptarë iu drejtuan Mitrovicës. Më 30 mars 1903, rreth 2,000 vetë, nën udhëheqjen e Isa Boletinit, shqiptarët sulmuan garnizonin otoman në Mitrovicë. Pikërisht në këtë kohë Shçerbin inspektoi trupat turke dhe kërkoi shtimin e forcave për t' i detyruar shqiptarët që të tërhiqen nga qyteti. Inspektimin e këtyre forcave e përsëriti edhe të nesërmen, por plagoset rëndë nga Ibrahim Popoci, dhe vdiq më 10 prill 1903. Pas luftës në Kosovë (1999), Serbia ia ngriti një përmendore në Mitrovicën e Veriut. (Islam Lauka)

SHEH MUHIDINI (1920-1998). Sheh i Teqesë së Madhe Halvetie në Rahovec. Ishte njëri nga udhëheqësit më të shquar të kësaj teqeje. Postin e shehut e mori më 1940, kur nisi edhe drejtimin e Teqesë së sheh Sylejmanit, në të cilën ai ishte pasardhësi i 12-të. Gjatë pushtimit italian, qëndroi në Shqipëri. Në vitin 1942 mori pjesë në Kongresin e Alevive. Pas Luftës së Dytë Botërore iu bashkëngjiti Lëvizjes Nacional Demokratike Shqiptare (LNDSH). Nën udhëheqjen e tij, Teqeja e Rahovecit u kthye në simbol të rezistencës kombëtare gjatë gjithë periudhës pas Luftës së Dytë Botërore e deri në luftën e fundit në Kosovë. Në vitet '50 u angazhua hapur kundër shpërnguljes së shqiptarëve në Turqi. Për shkak të bindjeve politike dhe aktivitetit kombëtar, u burgos tri herë nga pushteti jugosllav. Në vitet '90 doli në përkrahje



SHEH MUHIDINI

të protestave kundër mbylljes së shkollave shqipe, mori pjesë aktivisht në lëvizjen për pajtimin e gjaqeve, pastaj në aksionin "Familja ndihmon familjen" etj. Ishte mbështetës i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, duke inkuadruar edhe pjesëtarë të familjes së tij në radhët e saj. Sheh Muhidini u ekzekutua në Teqenë e Madhe Halvetie në Rahovec nga forcat policore dhe paramilitare serbe në korrik të vitit 1998. Në vitin 2013 u shpall "Hero i Kosovës". (Metin Izeti)

SHEHDULA Meritë (1944-). Kimiste, profesoreshë universiteti. Lindi në Prizren, shkollën fillore e kreu në Gjakovë, gjimnazin në Prishtinë. Studimet për kimi i kreu në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore (FSHMN) të Universitetit të Prishtinës (UP) më 1968, ndërsa studimet pasuniversitare në Universitetin e Zagrebit (1981). Tezën e disertacionit e mbrojt në FSHMN të UP-së në vitin 1987. Një kohë punoi në laboratorin kimik të Azotikut në Kombinatin xehetar-energjetik "Kosova" në Obiliq. Më pas zgjidhet asistente në seksionin e kimisë në FSHMN të UP-së (1973) dhe në vitet vijuese i merr të gjithë titujt universitarë. Ka ushtruar detyra me përgjegjësi në institucionet e arsimit të lartë të Kosovës. Ka publikuar punime shkencore dhe kumtesa në revistat vendore dhe ndërkombëtare. (Nexhat Daci)

SHEHDULA-GJAKOVA Emine (1905-1975). Veterane e arsimit. Lindi në Gjakovë, ku mbaroi një shkollë "plotore" dhe më pas shërbeu si mësuese e vajzave në qytet. Në vitin 1922 kaloi në Shqipëri. Fillimisht u emërua mësuese në Shkodër, pastaj në Kavajë, ku punoi deri në vitin 1941, kur u kthye në Gjakovë, vazhdoi punën e saj si mësuese dhe ndihmoi Luftën Antifashiste. Veprimtarinë e saj si mësuese në Gjakovë e vazhdoi edhe pas Luftës së Dytë Botërore, deri në fillim të viteve '50 të shek. XX, ku u pushua nga puna nga autoritetet jugosllave, me pretekst se ishte mësuese nacionaliste. Për shkak të represionit të regjimit serb ndaj Emine dhe familjes së saj, në vitin 1960 emigroi në Shqipëri. Për veprimtarinë e saj në fushën e arsimit u nderua me çmime dhe dekorata. (Afërdita Deva-Zuna)

SHEHI Adem (1957-). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Lindi në fshatin

Farkë të Tiranës. Kreu Shkollën e mesme ushtarake “Skënderbej” në Tiranë. Mbaroi Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve më 1979 dhe mori gradën oficer artilerisë kundërajrore. Kreu detyra të ndryshme në njësitet e Ushtrisë Shqiptare, deri në përfshirjen në radhët e UÇK-së në Kosovë. Nga viti 1997 u mor me përgatitjen e anëtarëve të UÇK-së, duke shfrytëzuar bazën materiale të njësitit ushtarak ku ishte epror. Në muajin mars të vitit 1999 kaloi në Kosovë, në malësinë e Gollakut dhe u emërua komandant i Brigadës 153 të UÇK-së. E drejtoi këtë brigadë gjatë periudhës mars-qershor 1999, me të cilën hyri edhe në Prishtinë. Pas mbarimit të luftës u kthye në Tiranë. (Dilaver Goxhaj)

SHEHU Bashkim (1952-). Kompozitor. Lindi në Pejë. Pas Shkollës së Mesme të Muzikës në Prishtinë, studioi drejtimin për kompozitor në Akademinë e Muzikës në Sarajevë, te prof. Miroslav Shpiler (1975) dhe specializimin dyvjeçar (format muzikore dhe orkestrimi) në Paris. Studimet pasuniversitare i përfundoi po në Sarajevë. Nga viti 1981 punoi në redaksinë e muzikës në Radiotelevizionin



BASHKIM SHEHU

e Prishtinës, më pas u angazhua si asistent në Fakultetin e Arteve në Prishtinë. Ishte dekan i Fakultetit të Arteve në fillim të viteve '90, kur dhe u shpërngul në Pulë të Kroacisë dhe realizoi aktivitetin muzikor, artistik e pedagogjik në Fakultetin Pedagogjik të atij qyteti. Atje themeloi Orkestrën Simfonike, ishte drejtor artistik i programit “Vera e Pulës” (“Pulsko ljet”), i Festivalit të Istrës, ndërsa nga viti 2003 ishte dekan i Akademisë së Muzikës. Ka kompozuar gjini muzikore vokale, instrumentale, orkestrale, vokale-instrumentale e skenike. Në shumë prej tyre vërehen inspirime motivesh shqiptare. Ndër veprat e tjera shquhen: kënga solo “Ngadhënjimi i madh”; këngët korale “Të lindet njeriu”, “Elegji për R. Mulliqin”; Suita nr 1 e 2 nga baleti “Besa”, suita istriane “Balun”; “Folk freska” për orkestër simfonike; Concertino për piano e orkestër; Kuinteti frymor; “Refleksione 3” për fizarmonikë solo e orkestër, si dhe kompozime për teatër, televizion dhe film “Lepuri me pesë këmbë”. (Kristina Palokaj-Perkola)

SHEHU Bedrush (1933-). Historian, profesor universiteti. Lindi në Gjakovë. Shkollën fillore dhe shkollën normale i kreu në Gjakovë. Studimet për histori i kreu në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Sarajevës (1965). Pas diplomimit punoi në shkollat e mesme të Gjakovës. Në vitin 1968 u zgjodh asistent në degën e historisë të Fakultetit Filozofik në Prishtinë. Studimet pasuniversitare i vijoi në Universitetin e Beogradit, ndërsa disertacionin e doktoratës e mbrojti në Universitetin e Prishtinës (1981). Botoi një sërë artikujsh shkencorë brenda dhe jashtë vendit, ndërsa doktoratura e tij “Çështje shqiptare në vitet ‘30 të shekullit XIX” u botua në vitin 1990. Gjatë viteve '90, pas vendosjes së masave të dhunshme të Serbisë në Universitet, vazhdoi punën e profesorit në institucionet e pavarura të Republikës së Kosovës. Pas luftës në Kosovë punoi edhe disa vjet në arsimin pasuniversitar. (Alban Dobruna)

SHEHU Bekim (1974-). Gazetar. Lindi në Junik të Deçanit. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Junik, studimet për histori i kreu në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës (1997). Studioi edhe për gazetari. Në vitin 1998 punoi për shërbimin botëror të radios britanike BBC, si korrespondent nga Kukësi i Shqipërisë, ndërsa një vit më vonë bëhet korrespondent nga Prishtina i radios gjermane “Deutsche Welle”. Nga janari i vitit 2012 filloi punën si gazetar në Radio-Kosovë, ndërsa nga viti 2014 është zyrtar për komunikim me publikun në Radiotelevizionin e Kosovës. (Rrahman Paçarizi)

SHEHU Fahredin (1972-). Shkrimtar. Lindi në Rahovec. Kreu shkollimin fillor dhe të mesëm në vendlindje, ndërsa studimet i mbaroi në Universitetin e Prishtinës. Punoi si drejtor i departamentit të kulturës në komunën e Rahovecit, ndërsa tash është administrator dhe përkthyes në bordin e drejtorëve të Radiotelevizionit të Kosovës. Ka botuar përmbledhjet me poezi “Nun” (1996) dhe “Kun” (2007), pastaj librin me proza poetike “Shumësi e padukshme” (2000), përmbledhjen me tregime “Elemental 99” (1999) dhe romanet “Nektarina” (2004), “Manat” (2012) dhe “Hojet” (2013). Krijimet e tij poetike janë përkthyer në disa gjuhë dhe janë përfshirë në antologji dhe botime të ndryshme. Ka marrë

pjesë në aktivitete dhe festivale ndërkombëtare të letërsisë. Merret dhe me shkrime eseistike në fushën e trashëgimisë shpirtërore, të botuara në revista vendore e ndërkombëtare. (Adil Olluri)


SHEHU Gjyltekin (1937-2010). Gjuhëtar, përkthyes, profesor. Lindi në Nesalcë të Bujanocit. Shkollën fillore e mbaroi në vendlindje, të mesmen në Kumanovë, Gjakovë dhe Prishtinë.



GJYLTEKIN SHEHU

Studimet për gjuhët romane i kreu në Universitetin e Shkupit, ndërsa studimet pasuniversitare i ndoqi në Zagreb dhe në Paris. Më 1966 u certifikua për fonetikë në Paris. Më 1971 përfundoi studimet pasuniversitare në fushën e letërsisë krahasimtare në Zagreb. Më 1978 në Paris mbrojti disertacionin me titull: “Korsika dhe Shqipëria në letërsinë frënge të shek. XIX vrojtuar në aspektin historik, letrar e folklorik”. Punoi në vendlindje si mësues i frëngjishtes, referent për arsim dhe kulturë dhe mësimdhënës i gjuhës latine në Prishtinë, zëvendësudrejtor i Arkivit të Kosovës (1969-1972). Nga 1972 mësimdhënës në Universitetin e Prishtinës. Ishte anëtar i shumë asociacioneve dhe shoqatave kombëtare dhe ndërkombëtare. Ka shkruar artikuj kulturorë, libra mësimorë të gjuhës frënge (për shkolla fillore dhe të mesme), përktheu (letërsi artistike dhe dokumente historike) dhe botoi studime gjuhësore, historike, antropologjike, etnografike dhe kulturore. (Agnesa Hasimja)

SHEHU Hadi (1949-2017). Aktor. Lindi në Gjakovë. Shkollën fillore dhe atë të mesme i kreu në vendlindje. Fillimisht ndoqi studimet në Shkollën e Lartë Pedagogjike të Gjakovës,



HADI SHEHU

ndërsa më paskreu studimet për aktrim në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prishtinë (1976). Krijimtarinë artistike si aktor profesionist e filloi në Teatrin Popullor të Gjakovës. Në periudhën 1981-1996 dhe më pas 1999-2006 ishte drejtor i këtij teatri. Luajti një numër të madh rolesh në teatër, film dhe televizion. Në Teatrin Popullor të Gjakovës luajti në shfaqje dhe role të

ndryshme, nga të cilat veçohen: “Fisheku në pajë”, “Epoka gara Gjyqit”, “Pjata e drunjtë”, “Dragoi i Dragobisë”, “Pirrua”, “Armiku i popullit”, “Monserati”, “Halili e Hajria”, “Unë Halil Garria”, “Pylli”, “Babai”, “Agu”, “Njeriu me top”, “Tartufi”, “Dasma e trojeve tona”, “Antigona”, “Katër epoletat”, “Monedha e Gentit”, “Një varr për majorin e mbretit” etj. Në role të ndryshme në po këtë teatër luajti edhe në shfaqjet: “Babai im kullak socialist”, “Elena Gjika”, “Quo Vadis”, “Parfumeria”, “Gjakova një luftë ndryshe” etj. Përveç në Gjakovë, në cilësinë e aktorit mysafir, luajti edhe në Teatrin Kombëtar të Kosovës në shfaqjet “Pallati i ëndrrave” dhe “Korridorët e tmerrit”, në Teatrin Kombëtar të Tiranës në shfaqjen “Shfaqja e fundit”, në Teatrin e Pejës në shfaqjen “Unë burri i vjehrrës” etj. Më 2015, në Teatrin e Gjakovës luajti sërish në shfaqjen “Pjata e drunjtë”, me të cilën ka përmbyllur krijimtarinë e tij artistike skenike. Krahas teatrit, që nga vitet ’70 luajti edhe në filmat: “Si të vdiset”, “Kur pranvera vonohet”, “Era dhe Lisi”, “Gjurmë të bardha”, “Përroi vërshues”, “Pikniku”, “Era e mollës”, “Kur shpirti ndërron jetë” etj. Luajti edhe në disa filma të metrazhit të mesëm, si: “Tre veta”, “Etja dhe uji i Zemzemit” etj. Për kreacionet artistike u nderua me çmime të ndryshme në festivale të ish-Jugosllavisë, ndërsa pas luftës mori çmimin për vepër jetësore nga komuna e Gjakovës (2005), Medaljen Presidenciale të Meritave (2013), çmimin kombëtar për vepër jetësore nga Ministria e Kulturës (2012). (Bekim Lumi)

SHEHU Islam (1944-). Matematikan, profesor universiteti. Lindi në Junik, ku kreu shkollën fillore, shkollën e mesme e mbaroi në Pejë dhe më 1971 u diplomua në degën e matematikës në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore (FSHMN) të Universitetit të Prishtinës (UP). Po në atë vit zgjidhet asistent në departamentin e matematikës të FSHMN-së. Studimet pasuniversitare i kreu në FSHMN të Universitetit të Zagrebit (1981), ndërsa tezën e disertacionit të doktoratës e mbrojti në FSHMN të UP-së (1985). Në vitet vijuese avancohet në të gjitha gradat universitare dhe më 2004 bëhet profesor ordinar. Ka bërë vizita studimore jashtë vendit dhe ka marrë pjesë me kumtesa në tubime të ndryshme shkencore. Ka publikuar punime shkencore në revista ndërkombëtare e vendore dhe ka botuar disa tekste për shkolla të mesme dhe tekste universitare (“Analiza matematike

III”, “Bazat e matematikës me biometri” etj.). (Minir Efendija)

SHEHU Maksut (1930-2006). Shkrimtar, gazetar. Lindi në Prishtinë, ku kreu shkollën fillore dhe të mesmen. Studioi biologjinë në Universitetin e Beogradit. Pjesën më të madhe të jetës punoi në gazetën “Rilindja”, gazetar, reporter i lirë, korrespondent nga SHBA-ja dhe kryeredaktor, kurse një kohë të shkurtër në Televizionin e Prishtinës. Shkroi për fëmijë dhe për të rritur: poezi, tregime dhe romane. Tematika e krijimtarisë së tij është e larmishme, që nga aktualiteti e deri te epoka e lavdishme e Skënderbeut. Pas vdekjes iu botua romani “Qielli pa pëllumba”, në të cilin jepet një tablo e gjerë e jetës në Prishtinë dhe në rrethinë gjatë Luftës së Dytë Botërore, nëpërmjet një galerie të pasur personazhesh dhe me situata dramatike e tragjike, duke ofruar një lëndë interesante dokumentare për një mjedis shoqëror, i cili ka gjetur pak vend në letërsinë tonë bashkëkohore. Veprat e botuara: “Kurora e kuqe” (1960), “Jemi dy motra” (1964), “Letër pranverës” (1965), “Gruri dhe ari” (1967), “Nipi i minatorit” (1970), “Dielli lind në jug” (1971), “Togu i egër” (1990) etj. (Arif Demolli)

SHEHU Mefail (Mefaili i Madh) (1898-1945). Veprimtar antikomunist dhe udhëheqës i forcave nacionaliste të Ballit Kombëtar në Maqedoninë Perëndimore. Lindi në Zajaz (Kërçovë). Në Mbretërinë Jugosllave punoi si xhandar. Në vitin 1941 formoi njësinë vullnetare të Ballit Kombëtar. Bashkëpunoi me grupet nacionaliste, veçanërisht me Xhemë Hasë Gostivarin. Luftoi kundër njësiteve bullgare dhe njësiteve partizane dhe çetnike në Dibër, Gostivar, Tetovë dhe Shkup. Në fund të vitit 1944 me një numër luftëtarësh u tërhoqën në malet e Bacishtit, ku rezistuan me armë deri në vjeshtë të vitit 1945. U ekzekutua nga forcat partizane dhe trupi i tij u ekspozua para komunës së Kërçovës. U varros pa shenjë në Kërçovë. (Riza Sadiku)

SHEHU Tahsim (1938-1995). Piktur. Lindi në Prizren. Kreu shkollën fillore dhe të mesme në Prizren, ndërsa Shkollën e Lartë Pedagogjike, degën e artit figurativ, në Prishtinë (1967). Në vitet 1967-1974 punoi në shkollën e mesme “Gani Çavdarbasha” në Prizren dhe më pas kreu studimet në Akademinë e Arteve në Prishtinë

(1979). Nga viti 1977 punoi në Qendrën Speciale Shkollore për Fëmijë në Prizren deri më 1991 kur u përjashtua nga regjimi serb. Si anëtar i Shoqatës së Artistëve Figurativë të Kosovës mori pjesë në disa ekspozita kolektive brenda dhe jashtë vendit. Për disa vjet ishte kryetar i Klubit të Pikturëve të Prizrenit. Hapi disa ekspozita personale: në Prizren (1969, 1972, 1975), Prishtinë (1975), Beograd (1971, 1975) etj. Tablotë e tij pasqyrojnë me besnikëri pamjet e Prizrenit të vjetër. Në motivet reale ndihet një ndjenjë nostalgjie. Është fitues i disa çmimeve dhe mirënjohjeve për punën e tij krijuese. (Rexhep Goçi)

SHEHU Xhemil (1957-). Inxhinier i arkitekturës. Lindi në Gjakovë. Shkollimin fillor dhe të mesëm i kreu në vendlindje, ndërsa Fakultetin e Arkitekturës dhe të Urbanizmit në Universitetin e Sarajevës (1980). Karrierën profesionale e filloi në kombinatin ndërtime “Dukagjini” dhe në komunën e Gjakovës (1981-1986). Mori titullin IDA SIA dhe OTIA nga Shoqata e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Zvicër të Kantonit të Tiçinos (1990). Në zyrën arkitektonike “Gebrüder Senn” të St. Gallenit angazhohet si arkitekt konservator në fushën e rivitalizimit dhe të konservimit të zonës së vjetër të qyteti (1987-1989). Në fushën e urbanizmit dhe të projektimit arkitektonik, angazhohet në zyrën arkitektonike “Holler AG-Valis” në projektin e kompleksit shumëfunktional “Nimwaert” (1989-1990); në zyrën arkitektonike “Python&Kunz Partner” në SA-Fribourg bën hartimin e planit rregullues urb-arkitektonik të mbi 100,000 m² për lagjet “Platy” në Villars-sur-Glâne dhe “Beausejour Sud” në Givisiez (1990-1995). Në Lugano projektton, investon dhe ndërton (në bashkëpunim me Bankën Shtetërore të Kantonit të Tiçinos) vila, komplekse rezidenciale etj. Ka marrë çmime në konkurse prestigjioze për projekte arkitektonike në Friburg (Zvicër), në Prishtinë, Prizren, Durrës etj. Jeton dhe vepron në Lugano, Zvicër. (Vlora Navakazi)

SHEHZADE Musa (1870-1945). Atdhetar dhe titullar i fesë. Lindi në Gjakovë, në një familje të vjetër të tarikatit të sadive. Mësimet e para i kreu në Gjakovë, i vazhdoi në Prizren dhe në Stamboll. Krahas veprimtarisë fetare, ishte i përkushtuar edhe për çështjen kombëtare. Ishte deputet në parlamentin e fundit të Perandorisë Osmane, ku i mbrojti të drejtat e shqiptarëve.

Mori pjesë në Kuvendin e Junikut (1912). Si komandanti i forcave kryengritëse të Prizrenit, mori pjesë në çlirimin e Shkupit (gusht 1912). Mori pjesë në shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë në Vlorë. Pas kapitullimit të Mbretërisë së Jugosllavisë (prill 1941) u zgjodh prefekti i parë shqiptar i Prizrenit. Me një grup nacionalistësh, pas kapitullimit të Italisë, formuan Lidhjen e Dytë të Prizrenit. Ishte kryetar i kryesisë së punës së kuvendit themelues dhe u zgjodh kryetar i Komitetit Qendror të kësaj organizate. Për shkak të veprimtarisë së tij politike u ekzekutua pa gjyq nga OZNA, më 28 nëntor 1945. As sot nuk i dihet varri. (Masar Rizvanolli)

SHEJA Xhimi (Jamie Shea) (1953-). Zëdhënës i NATO-s gjatë bombardimeve të Aleancës mbi caqet serbe dhe ndërhyrjes në Kosovë, diplomat, ushtarak dhe profesor universiteti.



XHIMI SHEJA

Lindi në Londër, studioi për historinë moderne dhe frëngjishtën në Universitetin Sussex (1977), doktoroi në Universitetin e Oksfordit (1981). Nga viti 1985 ligjëroi për marrëdhëniet ndërkombëtare në disa universitete të njohura në SHBA, Britani, Francë, Belgjikë etj. Paralelisht me karrierën akademike, zhvilloi karrierë të pasur politike dhe diplomatike. Gjatë viteve 1988-1991 ishte asistent i Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s për projekte të veçanta, më pas zëvendësues dhe zyrtar i lartë i planifikimit. Në periudhën 1993-2000 ishte zëdhënës i NATO-s dhe zëvendësues drejtor i informacionit dhe i shtypit në Selinë e Aleancës. Paraqitjet e tij publike në këtë periudhë i dhanë shumë popullaritet për shkak të fushatës së bombardimeve të Aleancës kundër forcave serbe në Kosovë. Nga tetori i vitit 2000 deri në mars 2003 ishte drejtor i informacionit dhe i shtypit po në selinë e NATO-s në Bruksel, ndërsa në periudhën 2003-2005 zëvendësues i ndihmësit të sekretarit të përgjithshëm për marrëdhënie me jashtë. Edhe në vitet në vijim vazhdoi të kryejë detyra me rëndësi në strukturat e larta të Aleancës Atlantike. (Frashër Demaj)

SHEJHUL-ISLAMËT SHQIPTARË. Titull nderi dhe titull zyrtar për dijetarët e dalluar

islamë. Shejhul-islami ka qenë autoriteti më i lartë fetar në qeverinë qendrore osmane dhe interpretuesi më autentik i shariatit. Vlefshmëria juridike e normave ligjore të shtetit kushtëzohej nga miratimi paraprak i tyre nga shejhul-islami. Pozita e tij u fuqizua në kohën e mbretërimit të sulltan Mehmetit II (1451-1481), kur shejhul-islami u barazua me sadriazemin, por me protokoll u rregullua që shejhul-islami të respektohej më tepër. Kurorëzimi në fronin e sulltanit të ri osman bëhej pas dhënies së betimit për besnikëri para shejhul-islamit dhe trupës së ulemave nga hierarkia më e lartë. Ai ishte kompetent të shpallte edhe përmbysjen e sulltanit nga fronin. Gjatë historisë pesëshekullore të Perandorisë Osmane në këtë pozitë janë emëruar 131 dijetarë të zgjedhur, në mesin e tyre edhe 5 me origjinë shqiptare. I pari nga kjo radhë ka qenë Mulla Abdylkerimi, i marrë rob si fëmijë në Kosovë gjatë kohës së Muratit II (1421-1451) dhe në pozitën e shejhul-islamit ka ardhur në vitin 1488. Por personaliteti më i shquar që ka mbajtur pozitën e shejhul-islamit (1503-1526) ishte Ali efendi Zenbilli (Shporta). Me fetfanë e tij lidhur me një ide hakmarrëse të sulltan Selimit I, ka shpëtuar popullsinë e krishterë e Gadishullit Ballkanik nga reprezalja që u kishte ndodhur myslimanëve në Gadishullin Iberik në vitin 1492, duke e deklaruar të paligjshme çdo ide hakmarrëse ndaj njerëzve të pafajshëm. Historianët njoftojnë se Ali Efendiu nga të krishterët shihej si engjell mbrojtës. Ndërkaq, pozitën e shejhul-islamit Sanullah efendi Shkupi e ka zënë 4 herë në periudhën 1599-1608, kurse Ibrahim bej efendi Ajvaz pashazade këtë pozitë e mbajti 2 herë (1774 dhe 1784). Abdurrahman Nesip efendi Libohova (1842-1914) erdhi në këtë pozitë më 1911 dhe e mbajti atë vetëm një vit. (Nehat Krasniqi)

SHEMA Isak (1940-). Studiues i letërsisë, profesor universiteti. Lindi në Beguncë të Vitisë. Mbaroi edukimin fillor në vendlindje, Shkollën Normale në Prishtinë, ndërsa studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin Filozofik të Prishtinës (1964). I përkiste brezit të parë të studentëve të kësaj dege. Më pas studimet pasuniversitare i vijoi në Universitetin e Beogradit, ndërsa tezën e disertacionit të doktoratës e mbrojti në Universitetin e Prishtinës (1999). Pas mbarimit të shkollës normale punoi si mësues, kurse nga viti 1968 u angazhua në



ISAK SHEMA

mësimdhënie të letërsisë në Fakultetin Filozofik të Prishtinës. I. Shema u mor me studimin e letërsisë bashkëkohore shqipe dhe botoi një sërë veprash nga kjo fushë: “Bibliografi e kritikës letrare shqiptare 1944-1974” (bashkautor Ibrahim Rugova, 1976), “Aspekte të letërsisë (1985)”, “Vrojtime letrare dhe artistike” (1995), “Vlerësime të letërsisë shqiptare” (1996), “Procedime letrare” (1999), “Çështje të arsimit kombëtar shqiptar” (2000), “Josip Relajeta dhe vepra” (2002), “Letërsia shqiptare e shekullit XX” (2005), “Ismail Kadare: Fitues i Çmimit The Man Booker International Prize 2005” (2006), “Studime letrare” (2008), “Kultura letrare bashkëkohore” (2015), “Identitete letrare” (2015). Gjithashtu është autor dhe bashkautor i disa veprave historike letrare, i teksteve shkollore dhe studimeve të ndryshme nga fusha e letërsisë. Për punën e gjatë pedagogjike dhe shkencore u nderua me çmime dhe mirënjohje. (Femi Cakolli)

SHEMA-LUZHA Besa (1972-). Studiuuese e muzikës, mësimdhënëse universiteti. Lindi në Prishtinë. Kreu shkollimin bazë muzikor në vendlindje, studimet e larta për piano në

BESA
SHEMA-LUZHA

Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës, ndërsa studimet pasuniversitare i kreu nga fusha e pedagogjisë muzikore. Në Londër, në Institutin e Edukimit mbrojti temën e disertacionit (2014). Më 1998 u angazhua si asistente në Fakultetin e Arteve për lëndët metodika e muzikës dhe didaktika muzikore, më pas si mësimdhënëse për këto lëndë. Gjatë studimeve të doktoratës ka prezantuar punime në konferenca (Kajro, Londër, Bolonjë, Tenerife, Prishtinë), disa të botuar në revista lokale e ndërkombëtare. Nga viti 2000 është angazhuar në zhvillimin e reformës së edukimit muzikor, përfshirë dhe hartimin e standardeve të zhvillimit të hershëm të fëmijëve (2005). Është bashkautore e tekstit “Edukatës muzikore X”. Shquhet për organizime koncertesh e festivalesh (“Java e Bahut”,

“Kamerfest”, “Shopen Piano Fest”) dhe aktivitete të ndryshme kulturore. (Arnisa Rexhepi)

SHEMSEDINI Zahadin (1950-). Fizikan, profesor universiteti. Lindi në Blaç të Dragashit. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje dhe në Prizren, Shkollën e Lartë

ZAHADIN
SHEMSEDINI

Pedagogjike, grupi fizikë-kimi, e kreu në Prizren (1968). Studimet për fizikë i kreu në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore (FSHMN) të Universitetit të Prishtinës (UP) në vitin 1973. Në vitin 1978 zgjidhet asistent në degën e fizikës në FSHMN të UP-së. Studimet pasuniversitare i kreu në FSHMN të Universitetit të Zagrebit, ndërsa tezën e disertacionit e punoi në Institutin për Energji Bërthamore në Vinçë afër Beogradit dhe e mbrojti në FSHMN të Universitetit të Prishtinës (1987). Gjatë viteve '90 punon në katedrën e fizikës të FSHMN-së, ndërsa më 2002 zë punë në Fakultetin e Edukimit të UP-së (2002). Në vitin 2013 emërohet ushtrues i detyrës së rektorit të Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren. Ka botuar punime shkencore në revista ndërkombëtare dhe vendore. Është autor dhe bashkautor i disa teksteve të fizikës për shkolla të mesme. (Rexhep Gashi)

SHEMSIU Hafiz Ymer (1895-1945). Teolog islam, atdhetar, rapsod. Lindi në Prishtinë. Mësimet e para i mori në Medresenë e Prishtinës e pastaj në atë të Shkupit. Gjatë shkollimit përvetësoi disa gjuhë të huaja dhe i thelloi dijet letrare dhe filozofike. Gjatë Luftës së Parë Botërore hapi një shkollë shqipe në fshatin Sazli, e cila u mbyll nga pushtuesit bullgarë, ndërsa H. Ymeri u burgos. Pas daljes nga burgu u aktivizua në radhët e Komitetit për Çlirimin Kombëtar të Kosovës, pastaj u bë pjesëtar i partisë politike “Bashkimi”, që udhëhiqej nga Ferhat bej Draga. Bashkëpunoi me Lëvizjen Kaçake. Gjatë viteve 1937-1941 organizoi fshehurazi mësimin shqip në xhaminë e Talinocit, ku shërbente si imam dhe ku ngriti edhe Komitetin e Kosovës. Në veprimtarinë e tij zë një vend të rëndësishëm edhe krijimtaria si rapsod popullor. Gjatë Luftës së Dytë Botërore kundërshtoi forcat

partizane-komuniste, të cilat pas marrjes së pushtetit e mbajtën në izolim deri në vdekje. (Ramadan Shkodra)

SHENGYLI Skënder (1960-). Futbollist, trajner. Lindi në Prizren. Hapat e parë në futboll i nisi në shkollën e futbollit “Liria” të Prizrenit, më pastaj luajti për KF “Vëllazëria” të Zhurit dhe në vitin 1981 kthehet në ekipin e parë të KF “Liria”. Aty luajti deri në vitin 1983. Nga viti 1983 e deri në vitin 1989 mbrojti ngjyrat e KF “Prishtina”, ku u dallua si njëri prej mbrojtësve të djathtë më të mirë jo vetëm në Prishtinë, por edhe në ish-Jugosllavi. Karrierën e futbollistit e vazhdoi në Turqi, ku luajti për KF “Karsiyaka” (1989-1991). Pas përfundimit të karrierës vepruese, u bë trajner, fillimisht në krye të shtabit teknik të KF “Liria”, pastaj trajner i grupmoshave të reja dhe bashkërendues në shkollën e futbollit “Liria”. Drejtoi edhe “Ballkanin” e Suharekës, “Vëllaznimin” e Gjakovës dhe “Prishtinën”. Aktualisht drejton KF “Liria”, të cilin më 2015 e riktheu në elitën e futbollit kosovar. (Vllaznim Bytyçi)

SHERIFI Enver (1954-). Biolog, profesor universiteti. Lindi në fshatin Malishevë të Gjilanit. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, studimet themelore për biologji i kreu në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore (FSHMN) të Universitetit të Prishtinës. Studimet pasuniversitare dhe ato të doktoratës i përfundoi në Universitetin e Novi-Sadit (1992). Ndoqi disa trajnime dhe specializime të ndryshme profesionale. Më 1982 zë punë në FSHMN, në departamentin e biologjisë, fillimisht asistent e me vonë ligjërues për lëndët anatomi dhe morfologji e bimëve, biostatistikë dhe një grup lëndësh të tjera për studimet pasuniversitare. Është autor dhe bashkautor i disa punimeve shkencore dhe ka marrë pjesë në konferenca shkencore ndërkombëtare. (Behxhet Mustafa)

SHERIFI Skënder (1954-). Shkrimtar. Lindi në Viti. Rrjedh nga një familje nga Tropoja, e arratisur në Kosovë, për t`u vendosur më vonë në Bruksel të Belgjikës. Kreu shkollimin fillor dhe të mesëm në Bruksel, ku i nisi edhe studimet për gjuhë e letërsi frankofone, të cilat i mbaroi në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Prishtinës. Ka punuar si gazetar i radiove dhe i shtypit belg për sektorin e kulturës së

artit, ndërsa më vonë mësimdhënës për letërsi frënge dhe marrëdhënie publike. Botoi një sërë veprash në gjuhën shqipe dhe në gjuhën frënge, në disa raste edhe botime dygjuhësh: “Lojë e kundërlojë” (1980), “Oksigjeni” (1989), “Ora e meteorëve” (1996), “Passion” (2003), “Atelietë e ëndrrave” (2005), “Emal” (2006), “Poezi” (2008), “Trio e përjetshme” (dramë, 2011), “Love” (poezi e prozë, 2012), “Borderline” (2014) etj. Jeton në Belgjikë. (Shaip Beqiri)

SHERIFI Zenun (1969-). Pikturor. Lindi në Tetovë, ku mbaroi shkollimin fillor dhe të mesëm. Kreu studimet për pikturë në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Tetovës (UT). Nga viti 2002 është i angazhuar në Fakultetin e Arteve të UT-ës. Si pikturor, i takon plejadës së re të krijuesve bashkëkohorë. Në pikturat e tij paraqet elemente të enterierit me sens original dhe me variacione të ndryshme kromatike. Është pjesëmarrës në disa ekspozita kolektive. Veçohen ekspozitat personale të realizuara në Paris, në “Cite Internationale des Arts” dhe në Tetovë, në Galerinë e Arteve. Është anëtar i Shoqatës së Artistëve Figurativë të qytetit të Tetovës. (Jëlldeze Asani)

SHËN FLORI DHE SHËN LAURI. Martirë të krishterimit. Ishin martirët e parë, që u martirizuan në Dardani (shek. II). Vëllezërit ishin gurgdhendës, të cilët u angazhuan të ndërtonin në Ulpianë një tempull pagan. Aty Flori dhe Lauri predikuan krishterimin, shëruan të sëmurët dhe pagat e tyre i ndanë për të varfrit. Pasi përfunduan tempullin, shkatërruan objektet pagane brenda tij dhe vendosën simbolet e krishtera. Pas këtij veprimi u torturuan, u ekzekutuan dhe u hodhën në pus. Eshtrat e tyre u nxorën nga pusi në kohën e sundimit të Konstantinit të Madh dhe, pasi qëndruan për pak kohë të varrosur diku në Ulpianë, reliket u dërguan në Konstandinopojë. Kisha paleokristiane në Lipjan mbante emrin e dy vëllezërve martirë. Gjurmë të kishave që mbajnë emrin e Shën Florit ka ende në Kosovë, siç është ajo pranë Gllgovicës së Gollakut. (Arben Hajdari)

SHËNDETËSIA NË KOSOVË. Sistemi i institucioneve publike dhe private në shërbim të ruajtjes së shëndetit të popullsisë, të parandalimit dhe të mjekimit të sëmundjeve. Sundimi osman dhe më vonë pushtimi serb

kushtëzuan një gjendje të rëndë shëndetësore në Kosovë. Pas Luftës së Dytë Botërore lindshmërisë së lartë (46.4% më 1954) i kundërvihej një vdekshmëri e përgjithshme e lartë (19% më 1951) me vdekshmërinë foshnjore 174.2 për 1,000 lindje të gjalla (1951). Jetëgjatësia më 1940 ishte pak më tepër se 45 vjet. Në këto rrethana paraqitej në shifra tronditëse malaria, e cila më 1946 kishte prekur mbi 90,000 banorë. Në shifra të larta ishin edhe tuberkulozi, tifoja e zorrëve, parazitozat, sifilizi, sëmundjet e lëkurës, sidomos ato të moshës foshnjore e fëmijërore: fruthi, difteria, poliomieliti etj. Kësaj gjendjeje i bashkëngjitej keqshqyerja, kushtet e rënda të banimit e të jetesës, niveli arsimor e kulturor i ulët etj. Kjo situatë përballohej nga një shërbim shëndetësor krejt i pamjaftueshëm: funksiononin vetëm 5 spitale me 333 shtretër dhe me një personel prej 17 mjekësh dhe 40 punëtorë shëndetësorë. Mungonin barnat e domosdoshme, vaksinat etj. Gjendja filloi të ndryshonte me hapjen e Fakultetit të Mjekësisë në vitin 1969. Më 1975 u hap dega e stomatologjisë, ndërsa ajo e farmacisë u hap në gjysmën e dytë të viteve '90. Deri në vitin 1990 në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë diplomuan 2,058 mjekë. Deri në heqjen e autonomisë (1989) në Kosovë funksiononin Fakulteti i Mjekësisë me 14 klinika dhe 5 institute, Enti për Sigurimin Shoqëror e Pensional, Enti për Mbrojtjen Shëndetësore të Kosovës me një rrjet të gjerë institucionesh parandaluese dhe mjekuese. Numri i shtretërve ishte 5,985 në raport me numrin e popullsisë, 1 mjek shërbente për 1,054 banorë dhe 3 shtretër për 1,000 banorë. Vaksinimi, në përputhje me objektivat e Organizatës Botërore të Shëndetësisë, mbulonte mbi 90% të kontingjentëve ku ai duhej të zbatohet. Falë këtij zhvillimi dhe masave parandaluese, u zhdukën një varg sëmundjesh, si: malaria, poliomieliti, difteria, tifoja ekzantematike, sifilizi, kalazari etj. Tetanosi i të porsalindurve u reduktua shumë. Fruthi dhe disa sëmundje të tjera ngjitëse u vunë nën kontroll. Këto masa kushtëzuan përmirësimin e disa treguesve shëndetësorë: u rrit dukshëm jetëgjatësia, moshja mesatare e popullsisë ishte e re, rreth 24 vjet (mosha 0-14 vjet kapte rreth 44% të popullsisë). Me gjithë uljen e lindshmërisë deri në 13% më 2013, vdekshmëria foshnjore dhe ajo e përgjithshme u ulën nga 174.2 (1951) në 13.5 për 1,000

lindje të gjalla (2014) dhe nga 19 % në 4.5 % (2014). Në fillim të viteve '90 filloi rrënimi i shëndetësisë së Kosovës: u pushuan nga puna më shumë se 2,500 punëtorë shëndetësorë (midis tyre 68 profesorë, 72 profesorë të asociuar etj.). Në institucionet shëndetësore të Kosovës u dërguan mjekë e teknikë serbë, ndërsa për popullsinë shqiptare u organizua shërbimi shëndetësor paralel, kryesisht në kuadër të Shoqatës bamirëse humanitare "Nënë Tereza" dhe të formave të tjera alternative. Shoqata "Nënë Tereza" me mbi 100 ambulanca dhe klinika arriti të mbulonte gjithë territorin e Kosovës. Pas çlirimit të Kosovës (1999) u krijuan kushtet për riorganizimin e shërbimit shëndetësor. Sipas të dhënave të viti 2014, në shërbimin publik shëndetësor të Kosovës shërbenin 13,077 punëtorë shëndetësorë, prej të cilëve 2,814 mjekë, 441 stomatologë, 13 farmacistë (në shërbimet publike), 194 teknikë të lartë, 7,307 infermierë etj. (Isuf Dedushaj).

SHËRBIMET ME VLERË TË LARTË SHTUESE. Aktivitete ekonomike dhe sektorë në të cilët krijohet një marginë, përkatësisht diferencë më e madhe midis kostove dhe të ardhurave (përfitimeve) në krahasim me sektorët e tjerë ekonomikë. Ka disa sektorë të prodhimit dhe të shërbimeve, të cilat në sajë të inovacioneve dhe integritit të komponentëve të ekonomisë së dijes dhe teknologjive të informacionit kanë afinitet të krijojnë një vlerë më të lartë shtuese. Shërbime të tilla janë: inxhinieringu dhe konsulenca, shërbimet financiare, industrinë farmaceutike, industria e softuerit, telekomunikimet, disa sektorë të edukimit, shërbimet mjekësore, turizmi dhe rekreacioni. Zhvillimi i këtyre shërbimeve dhe i produkteve bazohet në investimet në edukim dhe zhvillim të burimeve njerëzore. Shumë ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë konsiderojnë se çelësi i zhvillimit të shpejtë, afatgjatë dhe të qëndrueshëm në Kosovë, sidomos duke marrë parasysh strukturën moshore të popullatës, qëndron pikërisht te zhvillimi i këtyre sektorëve. (Muhamet Mustafa)

SHËRBIMET PUBLIKE. Produktet dhe shërbimet e ofruara drejtpërdrejt nga qeveria, ose nëpërmjet ndërmarrjeve publike në dobi të qytetarëve dhe komuniteteve, duke përjashtuar shërbimet e mbrojtjes dhe ato ushtarake, të

gjqësorit dhe legjislativit. Përfshijnë shërbimet e furnizimit me energji elektrike, ujë, menaxhim të mbeturinave, shërbimet në shkolla publike, shërbimet shëndetësore në institucione publike, transportin publik, transmetuesin publik radioteleviziv dhe shërbimet e telekomunikimit. Ofrohen nga të punësuarit në administratën publike, nga ministritë përkatëse dhe nga ndërmarrjet publike, të cilat qeverisen nga bordet që i emëron Qeveria përkatësisht Kuvendi i Kosovës. Këto shërbime absorbojnë më shumë se 1/3 e të gjithë të punësuarve në Kosovë. Ndërmarrjet publike siç janë ato të shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike, ato të telekomunikimit u janë nënshtruar ose pritet t'i nënshtrohen një procesi të privatizimit ose lejimit të operatorëve privatë, sidomos në sektorin e arsimit dhe të shëndetësisë. (Muhamet Mustafa)

SHËRBIMI AGRONOMIK SHQIPTAR NË KOSOVË DHE MAQEDONI (1941-1944).

U themelua në vitin 1941 dhe përfshiu një pjesë të Kosovës dhe të Maqedonisë. Dhori Laci u emërua shërbimtar i Inspektoratit Bujqësor në Kosovë, ku punuan edhe agronomë të tjerë: Niko Qafzezi, kryeinspektor i bujqësisë në Prefekturën e Prishtinës; Gjon Logoreci, kryeinspektor i bujqësisë në Prefekturën e Pejës; Myzafer Kallajxhi, kryeinspektor i bujqësisë në Prefekturën e Dibrës së Madhe; Gjon Mileta, inspektor i bujqësisë në Nënprefekturën e Gjakovës; Nush Ashiku, inspektor i bujqësisë në Nënprefekturën e Gjilanit; Kozar Dodmasaj, inspektor i bujqësisë në Nënprefekturën e Rahovecit; Xhelal Kokalari, inspektor i bujqësisë në Nënprefekturën e Ferizajt; Selam Shtylla, inspektor i bujqësisë në Nënprefekturën e Kërçovës. Agronom Grigor Vavako punoi në Kosovë me shoqërinë Shqiptaro-italiane "Sastep". Në disa ferma bujqësore shtetërore punuan disa teknikë nga Shqipëria, si Ilo Beshiri dhe Ibrahim Erebara (në fermën e Drenicës). (Latif Susuri)

SHËRBIMI GJEOLGJIK I KOSOVËS (SHGJK). Institucion shtetëror për hulumtime gjeologjike në Kosovë, në kuadër të Ministrisë për Zhvillim Ekonomik. Veprimtaria e SHGJK-së përmblodh hulumtimet gjeologjike me interes për Republikën e Kosovës: studimin gjeologjik; përpilimin e hartave gjeologjike në shkallë të ndryshme dhe plotësimin e hartave

ekzistuese me informacione të reja; rilevimin dhe hartografin gjeologjik kompleks përmes studimeve të ndryshme gjeofizike, gjeokimike e hidrogeologjike; hulumtimin dhe vlerësimin e resurseve minerale, të ujërave nëntokësore, ujërave mineralë dhe gjeotermalë; hulumtimet gjeologo-inxhinierike; studimet gjeologjike mjedisore; monitorimin dhe studimin e aktivitetit sizmik në territorin e Kosovës; krijimin dhe mirëmbajtjen e bazës shtetërore të të dhënave gjeologjike; hartimin e programeve, projekteve hulumtuese dhe strategjive në fushën e gjeologjisë etj. Pararendës i SHGJK-së ka qenë BVI-a për hulumtime gjeologjike e KSA Kosovës (1983-1990) dhe Instituti Gjeologjik i Kosovës (2012-2014). SHGJK u krijua me vendim të Kuvendit të Kosovës (2014), në kuadër të Ministrisë për Zhvillim Ekonomik, me seli në Prishtinë. Në kuadër të këtij shërbimi e ushtron veprimtarinë Muzeu Shtetëror i Kristaleve dhe Mineraleve "Trepça", që përfshin mbledhjen, studimin, ekspozimin dhe ruajtjen, analizimin dhe përpunimin në mënyrë profesionale dhe shkencore, si dhe mbrojtjen e mineraleve/kristaleve; si dhe sektori i sizmologjisë, që merret me monitorimin e tërmeteve dhe ngjarjeve sizmike në Kosovë. (Fidaim Sahiti)

SHËRBIMI KONSULLAR MESJETAR. Shërbimi diplomatik mesjetar në fillim bëhej përmes misioneve afatshkurtra dhe me karakter kalimtar, në mënyrë që më vonë të marrë zhvillim të qëndrueshëm dhe organizim të përhershëm. Prania e këtij shërbimi nëpër komunitat qytetare të zonave arbërore dëshmohej edhe me Statutin e Raguzës (1272) dhe me dokumente të tjera të shek. XIV-XV. Të tilla konsullata ndeshen në Artë, Durrës, Janjevë, Krujë, Mitrovicë, Novobërdë, Pejë, Prizren, Spinaricë, (Zvërrnec), Shkodër, Vlorë, Tivar, Trepçë, Ulqin etj. Në kolonitë e para raguzane nga fillimi i shek. XIV në Kosovë aktivitete gjyqësore kryenin konsujt. Së këndejmi, Këshilli i Madh i Raguzës, me propozim të Senatit (1332), kishte caktuar konsullin e përgjithshëm për Ballkan me seli në Prizren (*Quod eius mansio sit in Prisen*). Me kërkesë të tregtarëve raguzanë në Prizren, po ky këshill aprovon dispozitën e parë mbi konsujt raguzanë (prill 1332). Sipas kësaj dispozite, qendra e konsullit raguzan ishte Prizreni, mirëpo ai ishte i detyruar që, në

interes të tregtisë raguzane, të organizonte dy herë në vit panairë të mëdha në territoret e Ballkanit. Në kohën kur Prizreni pësoi rënie në aspektin ekonomik dhe primatin e morën qendrat xehetare të Kosovës, konsullata e përhershme (në vitet 1370-1396) kishte kaluar në Novobërdë. Po në këtë kohë (1388) u zgjodh konsulli gjeneral i Raguzës në Prishtinë. Nga fundi i shek. XIV, qeveria e Raguzës mori vendim për emërimin e një konsulli dhe gjykatësi për Novobërdë, Prishtinë dhe rrethe të tyre (*consul in Nouaberda, Pristina et illis partibus*). Përveç kësaj, Këshilli i Vogël i Raguzës nisi të caktonte komisione gjyqësore të përbëra nga një konsull me dy gjykatës, të cilët zgjidhnin në Prishtinë konflikte të veçanta të qytetarëve raguzanë (1399). Ndërkaq, më 1415 vepronte në Pejë konsulli raguzan (*in Pech ose in Forno*). Konsujt raguzanë i ndeshim edhe në Trepçë (1403), Janjevë (1423), Bellasicë (1424), Mitrovicë (1430) etj. Rënia e Novobërdës (1455) shkaktoi edhe zvogëlimin e numrit të konsujve në këtë qytet dhe në qytetet e tjera të Kosovës. (Jahja Drançolli)

SHËRBIMI PEDAGOGJIK-PSIKOLOGJIK NË SHKOLLË. Shërbim i veçantë profesional në shkollën fillore dhe të mesme, i cili kontribuon në avancimin e punës mësimore në shkollë. Mbështetur në ligjin mbi arsimin fillor dhe të arsimit të mesëm të KSA të Kosovës të vitit 1975, ky shërbim filloi në vitin 1978, me angazhimin e pedagogëve të parë në cilësinë e pedagogut të shkollës. Deri në fund të shekullit XX shumica e shkollave kishin pedagogun e tyre. Në fillim të viteve 2000, në një varg shkollash pedagogët u pezulluan nga puna. Kjo çështje më 2011 sërish u rikthye në vëmendjen e institucioneve qeverisëse dhe ligjvënëse të vendit. Me ligjin mbi arsimin parauniversitar në Kosovë (2011), u përligj edhe shërbimi pedagogjik-psikologjik i shkollës, i përbërë nga pedagogu dhe psikologu me kualifikime universitare master. (Linda Salihu)

SHIPOLI. Fshat në komunën e Mitrovicës, rreth 2 km në juglindje të qendrës komunale. Në afërsi të këtij vendbanimi, afër Fabrikës së FAFOS-it janë zbuluar gërmadhat e një vendbanimi të periudhës së neolitit. Në aspektin fizionomik dhe funksional tanimë është pjesë e zonës periurbane të qytetit të Mitrovicës. Në vitin 2000 kishte 630 shtëpi me

rreth 6,000 banorë. Nga objektet e standardit shoqëror ka shkollën fillore, zyrën e regjistrimit civil, bibliotekën etj. (Skender Halimi)

SHIPTAR. Emërtim përbuzës për shqiptarët e Kosovës, i përdorur gjerësisht nga serbët në situatat e përkeqësimit të marrëdhënieve shqiptare-serbe. Emërtimi u paraqit fillimisht në dokumentet e Partisë Komuniste të Jugosllavisë, në vend të shprehjes “arnaut”, e cila kishte qenë në përdorim në Mbretërinë e Jugosllavisë dhe ishte konsideruar emërtim përbuzës. Në Rezolutën e Konferencës së Bujanit (31 dhjetor 1943 dhe 1 e 2 janar 1944) në gjuhën serbe u përdor emërtimi “shiptar”, kurse Shqipërinë e kanë quajtur “Shipni”. Pas Luftës së Dytë Botërore në të folurit e përditshëm të njerëzve në Serbi emërtimi “shiptar” u bë sinonim për punëtorë që kanë punuar punë krahu (sharraxhi, mbledhës plehrash dhe punë të tjera të ngjashme). Nga ky emërtim serbët e kanë krijuar shprehjen tjetër edhe më përbuzëse “shifitar”, me të cilën u janë drejtuar shqiptarëve deri nga fundi i viteve ‘60. Esad Mekuli këtë shprehje e përdor në vjershën “Shifitar mos më thuej” (Shifitar mi ne kaži), 1953. Pas korrigjimeve të konsiderueshme në marrëdhëniet politike dhe shoqërore në Jugosllavi, në vitin 1968 u pranua emërtimi “Albanac” si zëvendësim për emërtimin “shiptar”. Emërtimi shiptar në vitin 1987 është bërë parashenjë e fushatës shoviniste antishqiptare, të cilën e kanë zhvilluar politikanët serbë, madje edhe anëtarët e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Serbisë, si dhe pjesa më e madhe e mjeteve të informimit në Serbi. Përdorimi i këtij emërtimi përbuzës është arsyetuar me faktin se shqiptarët kështu e quajnë vetveten. Pa marrë parasysh që në Kushtetutën e Republikës së Serbisë, e miratuar në vitin 1990, është pranuar emërtimi shqiptar (Albanac) edhe në regjistrim të popullsisë në vitin 1991, është përdorur emërtimi “shqiptar dhe “shqipja” gjatë kohës së regjimit të Slobodan Milosheviqit (1987-2000). Agjencia e lajmeve “Tanjug”, Ministria e Punëve të Brendshme e Serbisë dhe Ushtria e Serbisë në kumtesat e veta e kanë përdorur vetëm emërtimin “shiptar” dhe “shiptarski”. Edhe Kisha Ortodokse Serbe e ka përdorur po këtë emërtim, mirëpo në Fjalorin e gjuhës serbe (2007), të cilin e botoi “Matica srpska”, për shprehjen “Shiptar” thuhet: shih emërtimin

“Albanac”. Shprehja është përdorur dhe për të bërë ndarjen e shqiptarëve të Kosovës nga ata të Shqipërisë. (Naile Mala-Imami)

SHIROKA Filip (1859-1935). Poet dhe vepërimtar i Rilindjes Kombëtare. Lindi në Shkodër. U largua nga Shkodra më 1880 për shkak të pjesëmarrjes në ngjarjet e viteve 1878-



FILIP SHIROKA

1880 dhe pjesën më të madhe të jetës e kaloi në mërgim, në Egjipt dhe më pak në Liban, ku punoi si inxhinier hekurudhash. Jashtë atdheut bashkëpunoi me mërgimtarë e vepërimtarë të tjerë për çështjen shqiptare. Shkroi pak dhe po aq pak edhe botoi. Poezitë shqip i botoi kryesisht tek “Albania” e Konicës, te “Besa” e “Toska” të Milo Duçit, po aty pak a shumë edhe prozat dhe disa mbledhje folklori, poezitë dhe prozat e përsëritshme te “Elçija a Lajmtari i Zemrës së Krishtit”, në të cilën shfaqen edhe disa përkthime nga italishtja. Vjershën e parë “All, Albania, all’armi” e botoi në italisht, më 1880, në “L’Osservatore Cattolico” të Milanos. Po në italisht botoi disa artikuj e lajme në fletoret “L’Osservatore Triestino” dhe “Il Piccolo” të Triestës. Disa poezi dhe shkrime i botoi edhe me pseudonimet Geg Postriba dhe Ulqinaku. Botimet në trajtë libri janë të mëvonshme: më 1919 botoi librin “Shqipëria përpara konferencës së Paqes”, një përmbledhje dokumentesh që shqiptarët i patën paraqitur kësaj konference dhe më 1921 botoi në Shkodër përmbledhjen me proza me karakter fetar “Moji i të Dekunve a Kujtimi i Burgatorit në tridhet tregime”. Vëllimi me poezi “Zani i zemrës” që e kishte gati që më 1903, u botua në Shkodër vetëm më 1933. Nga datat poshtë poezive kuptojmë që vëllimit, produkt i hovit rinor i është shtuar vetëm poezia “Pleqëria” e botuar më 1931 (një nga poezitë më të bukura të autorit). Poetika e mallit dhe e melankolisë i jep jetë një poezie urbane, për të ndërtuar toponiminë e një qyteti të kujtimit, Shkodrën. Poezia hyrëse, që i jep titullin vëllimit, e shpall këtë poetikë. Vëllimi përmban rreth 30 poezi dhe gati po aq janë edhe poezitë e botuara të lëna jashtë vëllimit. Botimi i vëllimit me shumë vjet vonesë dëmtoi receptimin e tij, pasi temat dhe tonet e letërsisë identitare të Rilindjes,

në vitin 1933 kur u botua “Zani i zemrës” nuk ishin më dominante në letërsinë shqipe. Por ajo që ka mbetur e paprekur janë tonet e lehta, shkoderanishtja letrare dhe subjektiviteti i shpallur, mungesa e funksionalitetit në një pjesë të poezive, por që është shumë më i ndjeshëm në pjesën e poezive më “të angazhuara” të lëna jashtë vëllimit. F.Shiroka merr përsipër vetëm të ndërtojë subjektin e vet lirik përmes piketave të kujtimeve për qytetin e vet të lindjes, si nostalgji edhe për veten. Në këtë panoramë ka vend sidomos për nënën, si zanafillë e subjektit, si mall e si brengë, për natyrën, stinët, lulet, dallëndyshet, bylbylat. Pjesa tjetër e vëllimit me tema më të larta e me tone më të forta është e ngjashme me gjithë poetikën dominante të Rilindjes (ringjallja e figurave kombëtare Skënderbeu, Pirro; kushtrimi, zgjimi i vetëdijes kombëtare etj). Poezia e tij ndoshta më e bukur “Bukuria e vjerrshës” është një çelës autorial leximi e interpretimi, për poezinë e poetikën e F.Shirokës. Nga këndvështrimi metrik, F.Shiroka mbetet shumë pranë metrikës neolatine dhe në figuracion shpesh zgjedh personifikimin e krahasimin në vend të metaforës. Vetëm dy vjet pasi botoi vëllimin poetik, F. Shiroka vdiq në mërgim, në Bejrut. (Dhurata Shehri)

SHIROKA Gjon (1929-1997). Gazetar. Lindi në Prizren. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, kurse diplomoi në Fakultetin Filologjik në Beograd, në degën e gjuhës dhe letërsisë italiane. Me gazetari filloi të merret qysh në ditët studentore, kur botohej në Beograd revista “Zani i rinisë”. Pasi u kthye në Prishtinë vazhdoi punën në gazetën “Rilindja”, ku punoi për disa vjet në rubrikën e jashtme. Gjatë kësaj periudhe shkroi reportazhe nga disa vende të botës. Në fillim të viteve ‘70 një kohë ishte edhe drejtor i “Rilindjes”, ndërsa më pas shërbeu në diplomaci, si ambasador i Jugosllavisë në disa vende të botës. Vdiq në Bankok. (Nehat Islami)

SHIROKA Kolë (1922-1994). Funkionar i lartë komunist i Kosovës në ish-Jugosllavi. Lindi në Prizren, ku edhe kreu shkollën fillore. Si gjimnazist u anëtarësua në organizatën e rinisë komuniste jugosllave, për çka edhe u përjashtua nga shkolla. Më 1941 u bë anëtar i Partisë Komuniste të Jugosllavisë, më pas mori pjesë në Luftën Nacionalçlirimtare në

fillim si veprimtar i prapavijës, e nga viti 1943 në detyrën e komisarit politik të Aradhes së Sharrit, anëtar i grupit për propagandë në Komitetin Krahinor të Partisë Komuniste të Jugosllvisë (PKJ) dhe Shtabit Kryesor të Ushtrisë Nacionalçlirimtare dhe aradhave partizane të Kosovës. Pas luftime ishte sekretar i Komitetit të Rrethit për Rahovec, pjesëmarrës në Kuvendin e Prizrenit, ku u mor vendimi për aneksimin e Kosovës nga Serbia. Kreu shkollën politike “Gjuro Gjakoviç” në Beograd. Më pas ishte anëtar i forumeve më të larta partiake në Kosovë, Serbi dhe Jugosllavi, disa mandate deputet krahinor, republikan dhe federativ etj. Në vitet 1982-83 ishte kryetar i Kryesisë së KSA të Kosovës, pastaj sekretar i Komitetit Qendror (KQ) të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë (LKJ) dhe anëtar i kryesisë së KQ të LKJ-së, prej nga dha dorëheqje në vitin 1988. U shqua për diskurs të ashpër ndaj kundërshtarëve të vijës së partisë. Vdiq dhe u varros në Beograd. (Skënder Lutfiu).

SHIROKA Kolë B. (1925-1996). Muzikant. Lindi në Prizren. Aktivitetin muzikor dhe dramatik e filloi si amator para Luftës së Dytë Botërore. Ishte nga anëtarët e parë të Shoqërisë kulturore-artistike “Agimi”, në kor, orkestrinë, këngëtar, flautist. Ishte drejtor i Teatrit të Prizrenit. Për SHKA “Agimi” ka luajtur rol të rëndësishëm jo vetëm si interpret, por edhe përpilues tekstesh e partiturash në gjuhën shqipe. Më vonë ishte sekretar i Bashkësisë Kulturore-Arsimore të Kosovës. Merrej me organizimin e jetës kulturore nga festivalet deri tek ekspozitat. Ishte ndër themeluesit e korit “Collegium Cantorum”, të cilin një kohë e drejtoi vetë. Ishte autor përmbledhjesh dhe notifikimesh të 100 këngëve korale. Jeta, puna dhe aktiviteti i tij lidhet me artin muzikor dhe artet e tjera, si promovues e afirmues i tyre. (Rreze Kryeziu-Breznica)

SHIROKA Simon (1927-1994). Mjeshtër i artit plastik, filigranist. Lindi në Prizren. Profesionin e filigranit e mësoi te mjeshtri më i njohur në Prizren, Luz Kolveshi. Më vonë në Beograd mësoi mjeshtërinë e optikës, ndërkaq në Zagreb u specializua po në këtë lëmi. Duke ushtruar profesionin e filigranit, filloi të krijonte punime artistike me elemente të kombinuara, të cilat i realizoi me mjeshtri dhe invencion. Në punimet e tij përdori metale,



SIMON SHIROKA

vepra, i frymëzuar nga krijimtaria popullore, si: “Shqipëria vallëzon”, “Lojërat popullore” (në disa variante), figura të ndryshme me kostume popullore etj. S. Shiroka punoi edhe një cikël me rozeta. Hapi disa ekspozita personale dhe ishte pjesëmarrës në shumë ekspozita kolektive në Kosovë dhe jashtë. Mori shumë mirënjohje dhe çmime për punën e tij krijuese. (Blerim Luzha)

SHIROKA-PULA Justina (1953-). Ekonomiste, profesoreshë universiteti, anëtare korrespondente e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Lindi në Prishtinë, ku e



JUSTINA SHIROKA-PULA

kreu shkollimin fillor dhe të mesëm. Studimet i përfundoi në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës (1976). Studimet pasuniversitare i vazhdoi në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Zagrebit dhe doktoroi në Prishtinë, si femra e parë me këtë gradë nga fusha e ekonomisë në Kosovë, duke mbrojtur tezën e doktoratës me titull: “Investimet demografike dhe zhvillimi ekonomik i Kosovës”, e cila më pas u botua edhe si libër më vete. Një kohë punoi në Bankën Qendrore të Kosovës (1977), pastaj hyri në procesin mësimor në Fakultetin Ekonomik, ku vazhdon edhe sot, që nga viti 1978. Ka bërë vizita të shumta studimore në vende të ndryshme dhe ka udhëhequr Qendrën Ndërkombëtare për Biznes (IBC), ishte pjesëmarrëse në shumë projekte të rëndësishme në fushën e energjetikës, nga lëmi i menaxhimit dhe i vendimmarrjes, si dhe pjesëmarrëse në konferenca të ndryshme ndërkombëtare. Është autore dhe bashkautore e disa librave: “Metodat e transportit të programit linear” (2005), “Vendimmarrja menaxheriale” (2012) etj., si dhe i një numri artikujsh

gurë të fisnikëruar dhe përbërës të tjerë me gamë të pasur ngjyrash. Veprat e tij i stolisi edhe me filigranë të vjetër, të autorëve anonimë dhe autodidaktë (unaza, gjerdanë, kollanë, vathë, qostekë dhe stoli të tjera). Realizoi shumë

kreu shkollimin fillor dhe të mesëm. Studimet i përfundoi në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës (1976). Studimet pasuniversitare i vazhdoi në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Zagrebit dhe doktoroi në

shkencorë dhe profesionalë të botuar në revista vendore dhe ndërkombëtare. Ka qenë aktive edhe në jetën politike të vendit, deputete dhe ministre e Energjisë dhe e Minerave (2008-2011). Më 2016 u pranua anëtare korrespondente e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. (Ymer Havolli)

SHITA Vehap (1923-2014). Shkrimtar, kritik letrar, përkthyes. Lindi në Gjakovë. Kreu shkollimin në vendlindje, gjimnazin në Shkup dhe Prishtinë, ndërsa studimet për gjuhë dhe letërsi



VEHAP SHITA

shqipe në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Beogradit. Prej vitit 1949 u mor me veprimtari publicistike e letrare. Ishte redaktor i Shtëpisë Botuese “Mustafa Bakia”, i Radio Prishtinës, i gazetës “Rilindja”, i revistave letrare “Jeta e re” dhe “Stremljenja” të Prishtinës, i revistës së teatrit “Scena” të Novi-Sadit dhe i Leksikonit të Shkrimtarëve të Jugosllavisë (4 vëllime). Njihet ndër kritikët e parë në Kosovë, i cili është marrë aktivisht me probleme të kulturës, të letërsisë dhe të teatrit. Ka botuar një numër të madh artikujsh për këto fusha. Ka botuar librat: “Skena shqipe” (1966), “Gjurmave të letërsisë” (1970), “Kur ndizen dritat” (1977) etj., si dhe ka përkthyer vepra të ndryshme të letërsisë botërore në gjuhën shqipe, pastaj vepra të letërsisë shqipe, kryesisht në gjuhën serbokroate. Më 1990 ishte njëri nga themeluesit dhe anëtar i Kryesisë së Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave e të Lirive të Njeriut në Prishtinë dhe kryeredaktor i buletinit, të cilin e botonte ky asociacion. (Sali Bashota)

SHKA. Emërtim për serbët, bullgarët dhe për sllavët në përgjithësi. Në disa rrethana ka marrë konotacion përçmues. Është përdorur në Kosovë, në Maqedoni, në pjesën veriore të Shqipërisë, por edhe te rumunët ortodoksë dhe autoktonë në Ballkan. Për emërtimin janë dhënë shpjegime të ndryshme, por në burim nuk ka të bëjë me qasje raciste. Emërtimi shqa, shka, shkja (shkavell, shkie) konsiderohet të jetë formuar në kohën e dyndjes së sllavëve në Ballkan. Arbneshët e Zarës shkinisht e quajnë kroatishten. Po ashtu, është emërtim popullor që dallon përgjithësisht një person a

bashkësi në përkatësinë e tyre konfesionale, si “skizmatik”, “ortodoks sllavë”, prandaj me këtë term nga shqiptarët janë quajtur edhe grekët. (Ganimet Klaiqi)

SHKËMBINJTË. Agregate (bashkëshoqërime) minerale me përbërje e ndërtim të caktuar, që janë formuar si pasojë e proceseve gjeologjike dhe që shtrohen në korën e Tokës në trajtën e trupave të pavarur. Nga shkëmbinjtë është e ndërtuar litosfera (korja e Tokës). Shkëmbinjtë mund të jenë magmatikë, sedimentarë dhe metamorfikë. Shkëmbinjtë magmatikë formohen nga magma, si pasojë e ftohjes, ngurtësimit dhe kristalizimit të saj të ngadaltë në thellësi të korës së Tokës (shkëmbinj intruzivë: gabbro, graniti etj.), ose nga ftohja e shpejtë afër sipërfaqes apo mbi të (shkëmbinj efuzivë: andezitet, bazaltët etj.). Shkëmbinjtë sedimentarë (gëlqerorët, rëra, argjila etj.) janë formuar nga sedimentimi i lëndës së ngurtë (copëzave të shkëmbinjve, kripërave, skeleteve të organizmave), në një mjedis ujqor, lëndë që është krijuar nga shkatërrimi i shkëmbinjve të tjerë nga proceset eksogjene në sipërfaqen e Tokës. Shkëmbinjtë metamorfikë (gneisi, mermeri rreshpet) janë formuar nga shndërrimet e shkëmbinjve parësorë magmatikë e sedimentarë në gjendje të ngurtë, nga proceset e metamorfizimit, veprimet të shtypjeve dhe temperaturave të larta e solucioneve kimike në korën e Tokës. Në Kosovë shkëmbinjtë magmatikë intruzivë (granitet) kanë përhapje të madhe në masivin e Bujanocit (Karaçevë, Hogosht); shkëmbinjtë ultrabazikë në masivin ultramafik të Gjakovës, Rahovecit e Goleshit; shkëmbinjtë vullkanikë (andezitet, dacitet) në rrethinën e Mitrovicës, shkëmbinjtë metamorfikë (rreshpet) në Artanë (Novobërdë) e Hogosht, ndërsa shkëmbinjtë sedimentarë në fushëgropat e Dukagjinit, të Kosovës, të Moravës së Binçës, të Llapit, të Drenicës (rëra, zhavorre, argjila), në Carralëvë, Drenicë (flish), në Bjeshkët e Nemuna, Pashtrik (gëlqerorë, dolomitë etj.). (Naser Peci)

SHKODRA Faik (1944-). Mbledhës dhe studiues i folklorit, mësimdhënës. Lindi në Desivojcë të Kamenicës. Kreu shkollën e mesme në Gjiilan, ndërsa studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe i mbaroi në Universitetin e Prishtinës, ku më pas u magjistrua dhe mbrojti tezën e disertacionit të doktoratës. Ligjëroi lëndën letërsi për fëmijë dhe teoria e letërsisë në

Shkollën e Lartë Pedagogjike dhe në Fakultetin e Mësuesisë në Gjilan. U mor edhe me studime në fushën e letërsisë. Si mbledhës i folklorit, si bashkautor, botoi një vëllim me këngë e lojëra fëmijësh, pastaj veprat studimore “Përkime midis letërsisë popullore dhe poezisë së shkruar shqipe” (1995), “Nga tradita tek e sotmja” (1998), “Vështrime për letërsinë për fëmijë” (2000), “Letërsi për fëmijë nga fillimet deri sot” (2002), “Portrete dhe vepra” (2005), “Kur flasin poetët” (2009), “Në botën letrare të fëmijëve” (2009), “Arti i fjalës” (2011) etj. (Adem Zejnullahu)

SHKODRA Sadri (1944-2011). Matematikan, profesor universiteti. Lindi në Desivojcë të Kamenicës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje e Hogosht, shkollën e mesme në Gjilan (1964).



SADRI SHKODRA

Studio matematikën në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës (UP) dhe pas diplomimit zgjidhet asistent në Fakultetin Teknik në Prishtinë (1969). Studimet pasuniversitare i kreu në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore (FSHMN) të Universitetit të Zagrebit (1977), ndërsa tezën e disertacionit e mbrojti në FSHMN të UP-së (1991). Në vitet vijuese gradohet në të gjithë titujt universitarë. Për qëllime studimore qëndroi në disa universitete europiane. Publikoi punime shkencore në revista vendore e ndërkombëtare dhe tekste universitare (“Matematika” I, II, “Përmbledhje detyrash të zgjidhura nga matematika III”, “Statistika”). Mori pjesë me kumtesa në tubime shkencore brenda e jashtë vendit. (Minir Efendija)

SHKODRA Xhevat (1949-). Mjek i mjekësisë së punës, mësimdhënës universitar. Lindi në Desivojcë të Kamenicës, shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje dhe në Gjilan, ndërsa u diplomua në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë (1975). Pas diplomimit u emërua mjek në Gjilan, kreu specializimin për mjekësi të punës në Prishtinë dhe Beograd, ndërsa specializimin për sëmundjet reumatike në Zagreb. Gjatë viteve 1978-85 punoi në dispanserinë e mjekësisë së punës të kombinatit “Ramiz Sadiku” në Prishtinë, më pas në Institutin Kombëtar të

Shëndetit Publik. (1985-1991). Ndërkohë, kreu studimet pasuniversitare në Fakultetin e Mjekësisë në Zagreb, ndërsa temën e disertacionit të doktoratës e mbrojti më 1998 në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. Një kohë ishte mësimdhënës në Fakultetin e Kulturës Fizikë të Universitetit të Prishtinës, ndërsa ligjëroi në Fakultetin e Mjekësisë. Është kryetar i Kryqit të Kuq të Kosovës. Publikoi një sërë punimesh shkencore dhe profesionale. (Selvete Hoxha-Krasniqi)

SHKODRA Zija (1925–2002). Historian, specialist i historisë ekonomike dhe urbane të periudhës osmane. Lindi në Shkodër. Kreu arsimin e mesëm në Tiranë, kurse studimet e larta universitare, në fushën e ekonomisë, i nisi në Zagreb (1946-1947) dhe i përfundoi në Bukuresht (1950). Punoi si kërkues shkencor në Institutin e Shkencave, e më pas në atë të Historisë, fillimisht në Universitetin e Tiranës dhe më pas në Akademinë e Shkencave. Ka botuar dy studime monografike për historinë ekonomike dhe atë urbane të viseve shqiptare: “Esnafet shqiptare” (1973) dhe “Qyteti shqiptar gjatë Rilindjes Kombëtare Shqiptare” (1984). Këto dy vepra edhe sot e kësaj dite mbesin fundamentale për periudhën dhe për problematikën që trajtojnë. Ka botuar edhe broshurën “Shqipëria në kohën e Tanzimatit” (1959), si dhe një varg artikujsh të rëndësishëm studimorë në revista shkencore brenda dhe jashtë vendit. Ka marrë pjesë me kumtesa e referate në aktivitete shkencore, kombëtare dhe ndërkombëtare. (Dritan Egro)

SHKOLOLLI Erzen (1976-). Piktor. Lindi në Pejë. Kreu shkollimin fillor dhe të mesëm në vendlindje, ndërsa studimet për pikturë në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës.



ERZEN SHKOLOLLI

Është nga përfaqësuesit më të shquar të skenës së artit të ri të Kosovës dhe nxitës i dialogut ndërkulturor midis Kosovës e botës, si dhe brenda skenës së artit në Kosovë. Veprat e tij janë ekspozuar në ekspozita, në muze e galeri ndërkombëtare. Në Gjermani mori pjesë në “Manifesta 4” (2002) në Frankfurt (2003) në ekspozitën e kuruar nga René Block si dhe “Në grykën e Ballkanit” në Fridericianum, Kasel. Përveç kësaj, shumë vepra të E. Shkolollit

ekspozohen nën kujdesin e Harald Simanit në “E ardhmja është në Ballkan” në Vjenë (2003) dhe “Gëzimi i ëndrrave të mia”, Sevilla Bienale (2004). Kohët e fundit mori pjesë në ekspozitën “Ritornell. Nëntë Tregime” (2008) në Taxispallais në Insbruk. E. Shkolli mori pjesë dhe drejtoi edhe ekspozita të shumta ndërkombëtare të artit bashkëkohor, së fundi “Historia filloi” e artistëve nga Izraeli dhe rajoni i ish-Jugosllavisë (Qendra Izraelite për art digjital, Holon, 2007). Nga viti 2003 qe anëtar i Parlamentit European të Kulturës. Në vitet 2011-2015 ishte drejtor i Galerisë së Arteve të Kosovës. (Hivzi Muharremi)

SHKOLLA AMË. Institucion i pavarur arsimor (fillor, i mesëm) i cili, përveç paraleleve (klasave) qendrore ka edhe paralele të ndara në mjedise të tjera, që janë nën administrimin e organeve drejtuese të shkollës amë. Numri i shkollave amë në Kosovë ka shkuar duke u rritur. Në vitin shkollor 2004/05 kishte 611 shkolla të tilla, me 474 paralele të ndara, kurse dhjetë vjet më vonë, në vitin shkollor 2014/15 numri shkollave amë u rrit në 778, ndërsa numri i paraleleve të ndara u zvogëlua në 375 sosh. Disa nga paralelet e ndara u shkëputën nga shkollat amë dhe u shndërruan në institucione arsimore të pavarura. Në pavarësimin e tyre ndikoi edhe sigurimi i kuadrit të nevojshëm arsimor dhe ngritja e standardeve të infrastrukturës shkollore. (Azem Azemi)

SHKOLLA E LARTË ADMINISTRATIVE, PRISHTINË. Institucion i arsimit të lartë dyvjeçar në Kosovë, i themeluar në vitin 1959. Ishte shkollë për përgatitjen e kuadrove administrative me kualifikim të lartë. Studimet ishin në gjuhën serbokroate. Në këtë shkollë diplomuan tri gjenerata studentësh shqiptarë dhe serbë. Shkolla e Lartë Administrative ishte pararendëse e Fakultetit Ekonomik-Juridik në Prishtinë, i cili u themelua në vitin shkollor 1961/62. (Riza Brada)

SHKOLLA E LARTË BUJQËSORE, PRISHTINË. Institucion i arsimit të lartë dyvjeçar në Kosovë, në të cilin filloi mësimi në vitin 1960, me synim përgatitjen e kuadrit me kualifikim të lartë nga fusha e bujqësisë, për lavertari dhe blegtori. Ishte degë e Fakultetit të Bujqësisë në Zemun (Serbi). Studimet

ishin në gjuhën serbokroate. Kishte studentë të rregullt dhe me korrespondencë. Shkolla e Lartë Bujqësore ishte pararendëse e Fakultetit të Bujqësisë në Prishtinë, themeluar në vitin 1973. (Riza Brada)

SHKOLLA E LARTË EKONOMIKE-KOMERCIALE, PEJË. Institucion i arsimit të lartë dyvjeçar, në të cilin filloi mësimi në vitin 1960, me qëllim të përgatitjes së kuadrit ekonomik-komercial me kualifikim të lartë. Fillimisht mësimi zhvillohej në gjuhën serbokroate, ndërsa nga viti shkollor 1969/70 edhe në gjuhën shqipe. Në periudhën 1991-1999 studentët dhe mësimdhënësit shqiptarë u nxorën nga objektet shkollore dhe u detyruan që punën mësimore ta zhvillojnë në shtëpi-shkolla. Në vitin 2002 kjo shkollë u transformua në Shkollë të Lartë të Biznesit, e cila në vitin 2004 u shndërrua në Fakultetin e Biznesit. (Riza Brada)

SHKOLLA E LARTË PEDAGOGJIKE, GJAKOVË. Shkolla e Lartë Pedagogjike “Bajram Curri” në Gjakovë u themelua në vitin 1967. Ishte shkollë dyvjeçare me mësim në gjuhën shqipe për përgatitjen e mësimdhënësve për mësim lëndor në ciklin e lartë të shkollës fillore. Në fillim kishte tri degë: gjuhë e letërsi shqipe, matematikë dhe histori-geografi. Në vitin shkollor 1968/69 u hap edhe dega biologji-kimi, ndërsa në 1977/78 u hap edhe dega e mësimit klasor. Në vitin 1980 shkolla futet në gjirin e Universitetit të Prishtinës. Në vitet 1991-1999, veprimtarinë e vet shkolla e zhvilloi në kushte të jashtëzakonshme. Në vitin 2004 SHLP-ja e Gjakovës u shndërrua në qendër rajonale arsimore për mësimdhënës, pjesë integrale e Fakultetit të Edukimit me seli në Prishtinë. (Riza Brada)

SHKOLLA E LARTË PEDAGOGJIKE, GJILAN. Institucion i arsimit të lartë dyvjeçar në Gjilan. Fillimisht ishte akademi pedagogjike, e cila u themelua në vitin 1973, ndërsa veprimtarinë e saj e filloi në vitin 1975. Kishte dy drejtime: për edukatore të institucioneve parashkollore dhe për mësues të mësimit klasor. Në vitin 1978 kjo akademi u shndërrua në Qendër për Arsimin e Lartë të Mësimdhënësve. Në vitin shkollor 1983/84 filloi punën edhe grupi i gjuhës dhe i letërsisë shqipe, i cili pushoi së punuari në vitin shkollor 1983/84. Në vitin shkollor 1980/81 kjo qendër

arsimore transformohet në Shkollë të Lartë Pedagogjike “Skënderbeu” dhe përfshihet në kuadër të Universitetit të Prishtinës. Në këtë shkollë punuan dy grupe: për edukatore të institucioneve parashkollore dhe për mësimin klasor. Në periudhën 1991-1999 e zhvilloi veprimtarinë e vet në shtëpi-shkolla. Në vitin 2004 u shndërrua në qendër rajonale arsimore për mësimdhënës, pjesë integrale e Fakultetit të Edukimit, me seli në Prishtinë. (Riza Brada)

SHKOLLA E LARTË PEDAGOGJIKE, PRISHTINË. Institucion i arsimit të lartë dyvjeçar, i cili filloi punën në vitin shkollor 1958/59, fillimisht me mësim në gjuhën serbokroate. Qëllimi i saj ishte përgatitja e kuadrit arsimor me kualifikim të lartë për mësimin lëndor në klasat e larta të shkollës fillore tetëvjeçare. Nisi me dy grupe mësimore: matematikë-fizikë dhe biologji-kimi. Në vitin shkollor 1959/60 u hapën edhe dy grupe të tjera: gjuhë shqipe dhe letërsi dhe arsimiti i përgjithshëm me fizikë, kur filloi edhe mësimi në gjuhën shqipe. Në vitin vijues u hapën edhe dy grupe të tjera: gjuhë ruse dhe letërsi, gjuhë angleze dhe letërsi. Në vitin 1961 kjo shkollë hapi dy paralele të ndara në Prizren, me grupet: gjuhë serbokroate dhe letërsi jugosllave dhe gjuhë e letërsi shqipe. Ndërkohë, në këtë shkollë u hapën edhe grupe të tjera mësimore. Prej vitit shkollor 1973/74 deri në vitin shkollor 1999/2000, në këtë institucion të arsimit të lartë vepruan këto grupe mësimore: gjuhë dhe letërsi shqipe, mësimi klasor, matematikë, fizikë-kimi dhe bazat e arsimit politeknik. Në vitet 1991-1999 shkolla e zhvilloi veprimtarinë në kushte të jashtëzakonshme. Në vitin 2004 Shkolla e Lartë Pedagogjike e Prishtinës u shndërrua në qendër rajonale arsimore për mësimdhënës, pjesë integrale e Fakultetit të Edukimit. (Riza Brada)

SHKOLLA E LARTË PEDAGOGJIKE, PRIZREN. Shkolla e Lartë Pedagogjike “Xhevdet Doda” u themelua në Prizren në vitin 1962. Ishte shkollë dyvjeçare për përgatitjen e kuadrit arsimor për mësimin lëndor. Pararendëse të saj ishin dy grupe mësimore: gjuhë serbokroate dhe letërsi jugosllave dhe gjuhë e letërsi shqipe, paralele të Shkollës së Lartë Pedagogjike (SHLP) të Prishtinës. Në vitin shkollor 1962/63, në këtë shkollë u hapën edhe këto degë: gjuhë e letërsi angleze, matematikë me fizikë, gjuhë e letërsi

turke dhe gjuhë e letërsi ruse. Në vitin shkollor 1965/66 hapet dega kimi-fizikë, ndërsa në vitin shkollor 1969/70 hapen edhe degët fizikë me matematikë dhe kimi me matematikë. Në vitin shkollor 1975/76 e ndërpresin punën degët gjuhë e letërsi ruse dhe kimi me matematikë, më pas edhe dega fizikë me matematikë. Në vitin shkollor 1978/79 SHLP e Prizrenit i bashkëngjitet Akademisë Pedagogjike të këtij qyteti, përkatësisht mësimi klasor. Në periudhën 1991-1999 SHLP e Prizrenit e zhvilloi veprimtarinë e vet në shtëpi shkolla. Në vitin 2004 u shndërrua në qendër rajonale arsimore për mësimdhënës, pjesë integrale e Fakultetit të Edukimit me seli në Prishtinë. (Riza Brada)

SHKOLLA E LARTË TEKNIKE, FERIZAJ. Institucion i arsimit të lartë në Kosovë, i themeluar në vitin 1976 me synim përgatitjen e kadrove teknike me kualifikim të lartë. Fillimisht quhej Qendër e Shkollimit të Lartë dhe kishte seksionet për axhustator, saldues, automekanik dhe zdrukthëtar. Në vitin 1990 u transformua në Shkollë të Lartë Teknike, me dy degë: makineri me profilet makineri e prodhimit dhe termoenergjetikë dhe industri e drurit me profilin e përpunimit të drurit. N vitet 1991-1999 veprimtarinë e vet shkolla e zhvilloi në kushte të jashtëzakonshme, për shkak të administratës së dhunshme serbe. Në vitin shkollor 2004/05 Shkolla e Lartë Teknike u shndërrua në Fakultet të Shkencave Teknike Aplikative, njësi akademike e Universitetit të Prishtinës. (Riza Brada)

SHKOLLA E LARTË TEKNIKE, MITROVICË. Institucion i arsimit të lartë dyvjeçar në Mitrovicë, i themeluar në vitin 1961, me mësim në gjuhën serbokroate dhe shqipe. Fillimisht kishte vetëm degën e xehetarisë, ndërsa në vitin shkollor 1963/64 u themelua edhe dega e teknologjisë dhe disa vjet më vonë edhe dega e metalurgjisë. Nga viti shkollor 1974/75 shkolla kishte dy degë, makineri dhe elektroteknikë. Në vitin shkollor 1993/94 Shkolla e Lartë Teknike në Mitrovicë transformohet në Fakultet të Xehetarisë dhe Metalurgjisë, njësi akademike e Universitetit të Prishtinës. (Riza Brada)

SHKOLLA E LARTË TEKNIKE, PRISHTINË. Institucion i arsimit të lartë në Kosovë, në të cilën mësimi filloi në vitin shkollor 1961/62. Kjo shkollë me studime dyvjeçare, me mësim në

gjuhën serbokroate, kishte tri degë: makineri, elektroteknikë dhe ndërtimtari. Gjenerata e parë e studentëve diplomoi në vitin 1963. Në këtë shkollë u përgatiten pesë gjenerata kuadrosh teknike me kualifikim të lartë. Në vitin akademik 1965/66 Shkolla e Lartë Teknike u transformua në Fakultet Teknik me seli në Prishtinë. (Riza Brada)

SHKOLLA E MESME E ARTIT, PEJË. U themelua në vitin 1946 dhe fillimisht u quajt Shkolla e Artizanateve. Bashkëthemeluesit e saj ishin Vlado Radoviq, piktor akuarelist



SHKOLLA E MESME E ARTIT NË PEJË

nga Peja dhe Shahin Kryeziu, piktor nga Gjakova, që kishte studiuar në Akademitë e Arteve në Torino dhe Firenze të Italisë. Në vitin shkollor 1949/50 mori emrin Shkolla e Mesme e Arteve Aplikative. Gjatë viteve vijuese ndërroi disa herë emrin. Në vitin 1981 u quajt "Boro e Ramizi", më 1985 "Vëllazërim-bashkim" dhe përfundimisht, në vitin 1992 mori emrin "Odhise Paskali", të cilin e mban dhe sot. Fillimisht mësimi mbahej në gjuhën serbe. Pedagogë ishin Vlado Radoviq, Svetozar Kamenoviq, Bozha Prodanoviq dhe Rufin Llazoviq. Në vitin 1953 për herë të parë fillojnë të japin lëndët profesionale edhe dy mësimdhënës shqiptarë (të diplomuar në akademitë e arteve në Beograd), Shemsedin Kasapolli dhe Xhevat Gacaferi. Më vonë (1963) Blerim Luzha ka dhënë lëndët profesionale të drejtimit të tekstit, pastaj u angazhua Avni Ferizi, etj. Në këtë shkollë punuan dhe punojnë ende shumë nxënës të saj, të cilët u diplomuan në akademitë e ish-Jugosllavisë. Drejtorë të saj ishin Vlado Radoviq, Rista Otoviq, Luka Stankoviq, Verolub Radoviq, Radosllav Miketiç, Gëzim Begolli, Haxhi Kastrati, Emina

Rexhepi-Gorani dhe Abdyl Berisha. Shkolla e Mesme e Artit në Pejë ka traditë në arsimimin dhe edukimin e gjeneratave në lëmin e arteve pamore, të kulturës dhe të edukimit. Gjatë kësaj kohe shumë nxënës vazhduan studimet në akademitë e arteve në Beograd, Zagreb, Lubjanë dhe Sarajevë, ndërsa më vonë në Shkollën e Lartë Pedagogjike dhe në Akademinë e Arteve (tash Fakulteti i Arteve) në Prishtinë. Disa syresh studimet dhe specializimet i vazhduan në akademitë e njohura jashtë vendit. Nga kjo vatrë e arsimit të arteve pamore dolën shumë artistë që bënë emër brenda dhe jashtë vendit, duke afirmuar artin figurativ dhe aplikativ të Kosovës, nisur nga: Muslim Mulliqi, Tahir Emra, Gjelosh Gjokaj, Agim Çavdarbasha, Xhevdet Xhafa, Rexhep Ferri, pastaj Nusret Salihamixhiq, Shyqri Nimani, Nebih Muriq, Blerim Luzha, Fatmir Krypa, Nuredin Loxha, Agush Beqiri, Dragomir Jashoviq e shumë të tjerë. (Blerim Luzha)

SHKOLLA E MESME E BUJQËSISË, PRISHTINË. U themelua në vitin 1946, me mësim në gjuhën serbokroate. U hap për përgatitjen e kuadrit të mesëm për bujqësi. Prej



SHKOLLA E MESME E BUJQËSISË, PRISHTINË

vitit shkollor 1959/60 u hapën edhe paralelet e para për mësim në gjuhën shqipe. Në vitin shkollor 1961/62, në kuadër të kësaj shkolle hapet edhe drejtimi i veterinarisë. Në vitet '90 të shek. XX kishte tre lëmenj mësimorë: bujqësi, veterinari dhe ushqimor. Njëkohësisht, shkolla hapi paralelet e ndara në Keqekollë dhe Besi. Gjatë viteve '90 të shekullit të kaluar, për shkak të administratës së dhunshme serbe, shkolla e zhvilloi veprimtarinë në shtëpi-shkolla dhe kjo bëri që numri i nxënësve dhe i mësimdhënësve shqiptarë të zvogëlohej ndjeshëm. Në vitin

shkollor 1999/2000 shkolla bujqësore u kthye në objektin e saj dhe quhet Shkolla e Mesme e Agrobiznesit me Teknologji. (Bajram Shatri)

SHKOLLA E MESME E FIZKULTURËS, PRISHTINË. Shkollë profesionale për përgatitjen e kuadrit me kualifikim të mesëm për mësimdhënës të edukatës fizike në shkollën fillore dhe të mesme dhe për aktivitete sportive dhe rekreative në Kosovë. Filloi punën në vitin shkollor 1956/57, me 70 nxënës dhe 3 mësimdhënës, më mësim në gjuhën serbokroate dhe shqipe. Filloi në lokalet e gjimnazit të Prishtinës, ndërsa në vitin shkollor 1960/61 u transferua në një lokal të Shkollës Normale të këtij qyteti. Në vitin 1963 Shkolla e Mesme e Fizkulturës u mbyll, për t'iu bashkëngjitur Shkollës Normale të Prishtinës. Ndërkohë ishte hapur grupi i kulturës fizike në kuadër të Shkollës së Lartë Pedagogjike të Prishtinës. (Rexhep Osmani)

SHKOLLA E MESME E POLICISË, VUSHTRRI. Shkollë profesionale për përgatitjen e pjesëtarëve të Ministrisë së Punëve të Brendshme, për mbrojtjen e rendit publik dhe juridik, me seli në Vushtrri. U themelua në vitin 1974. Pararendëse të saj ishin paralelet e Shkollës së Mesme të Punëve të Brendshme të Kamenicës së Sremit (Vojvodinë). Shkolla punonte në përputhje me ligjin për arsim të mesëm në Kosovës (1973) dhe të ligjit të ushtrisë jugosllave. Mësimi për nxënës të rregullt në këtë shkollë zgjaste katër vjet. Plan-programin e lëndëve të përgjithshme e miratonte Pleqësia e Arsimit, ndërsa ato profesionale i miratonte Sekretariati i Punëve të Brendshme i Kosovës. Përzgjedhjen e kandidatëve të paraqitur për t'u arsimuar në këtë shkollë e bënte komisioni i veçantë i përbërë nga përfaqësues të shkollës dhe të Sekretariatit të Punëve të Brendshme. Shkolla kishte edhe konviktin e saj. Përveç mësimit të rregullt, shkolla organizonte edhe forma të tjera arsimore për aftësimin e policisë, pa shkëputje nga puna. Në vitin shkollor 1990/91, në këtë shkollë u vendos administrata e dhunshme serbe, me ç'rast u përjashtuan të gjithë mësimdhënësit dhe nxënësit shqiptarë. Prej vitit 1999 Shkolla e Shërbimit Policor të Kosovës menaxhohet nga OSBE-ja, me qëllim të formësimit të një policie moderne në Kosovë. Aplikantët në këtë shkollë duhet të kenë të kryer, së paku, shkollën e mesme, të

janë qytetarë të Kosovës, me moshë 21-55 vjeç. Trajnimi, përkatësisht aftësimi në këtë shkollë zgjat 20 javë. (Bajram Shatri)

SHKOLLA E MESME TEKNIKE, PRISHTINË. Shkolla e mesme teknike "8 Nëntori" në Prishtinë u themelua në vitin shkollor 1959/60, me tri drejtime: makineri, arkitekturë dhe elektroteknikë. Në vitin 1963 merret vendimi për integrimin e kësaj shkolle me Shkollën e Nxënësve në Ekonomi dhe formohet Qendra Shkollore Teknike, me këto degë: elektroteknikë, makineri dhe ndërtimtari, kurse shkolla për kualifikimin e punëtorëve kishte degët e elektroteknikës, të metalit dhe tekstilit. Ndërkohë, ka pasur edhe degë të tjera. Në periudhën 1977/1987, në këtë shkollë zhvilloi mësim faza e parë e bazave të përbashkëta me klasën e parë dhe të dytë. Pas kësaj periudhe në këtë shkollë vepruan degët për komunikacion, ndërtimtari-gjeodezi dhe dega juridike. Në vitet '90 shkolla kishte këta lëmenj: komunikacion i PTT-së dhe komunikacioni rrugor, ndërtimtari me arkitekturë, gjeodezi, grafikë dhe kimi-teknologji, që kryesisht veprojnë edhe sot. (Bajram Shatri)

SHKOLLA E PARË SHQIPE E VASHAVE NË PRIZREN. U themelua në kuadër të famullisë dhe ordinariatit të Argjipeshkvisë së Prizrenit në vitin 1892. Shkolla shqipe e vashave është themeluar sipas kërkesës së argjipeshkvit Carev, me vendimin dhe lejen e Propagandës Fide në Vatikan dhe në përkujdesje të diplomacisë austriake. Shkollën e udhëhoqën motrat e Rendit të Mëshirës, të cilat në Prizren erdhën me kërkesën e Propagandës Fide dhe të Ministrisë së Jashtme të Austrisë. Edhe pse në rrethana të vështira, numri i vajzave që shkolin në shkollë arriti në 70. Më vonë, në vitin 1909, shënohet se numri i nxënësve të kësaj shkolle kishte arritur në 120. (Pjetër Përgjoka)

SHKOLLA FILLORE. Shkolla e parë, elementare, e cila ofron dituri të përgjithshme dhe është baza e sistemit të arsimit në tërësi. Shkollat e para fillore në Kosovë ishin shkollat turke dhe serbe. Elementare ishin edhe shkollat katolike. Rrjeti i shkollave fillore shqipe në Kosovë u zgjerua gjatë Luftës së Dytë Botërore. Numri i tyre në Kosovë rritet me shpejtësi pas Luftës së Dytë Botërore, sidomos për mësimin në gjuhën shqipe. Në vitin shkollor

1944/45 në Kosovë punuan 278 shkolla fillore katërklasore, me mësim në gjuhën shqipe dhe në atë serbokroate. Gradualisht u rrit numri i tyre dhe numri i viteve të shkollimit, krahas me shtimin e viteve të arsimit të detyrueshëm. Me reformën e vitit 1958, arsimit të detyrueshëm në Jugosllavi, duke përfshirë edhe Kosovën, bëhet tetëvjeçar dhe, për rrjedhojë, themelohen shkollat fillore tetëvjeçare. Në vitin shkollor 1958/59 në Kosovë kishte 733 shkolla fillore (582 katërklasash, 3 gjashtë klasash, 32 shtatë klasash dhe 116 tetë klasash). Shkolla fillore tetë klasash zakonisht përbëheshin prej shkollës qendrore (amë) dhe paraleleve të ndara fizike. Masivizimi i shkollimit (arsimit) fillor luajti rol të rëndësishëm në emancipimin e shoqërisë dhe në zvogëlimin e numrit të analfabetëve. Në vitet '90 të shekullit XX, shkolla fillore shqipe në Kosovë u shkëput nga sistemi i arsimit serb dhe u bë pjesë integrale e sistemit të arsimit të Kosovës së pavarur. Me Ligjin mbi arsimin fillor dhe të mesëm në Kosovë (2002), shkolla fillore bëhet pesë klasash dhe përfshin fëmijët nga mosha 6-11 vjeç, duke përfshirë edhe fëmijët me nevoja të veçanta, sipas parimit të arsimit gjithëpërfshirës. Arsimit fillor është pjesë përbërëse e arsimit të obligueshëm nëntëvjeçar, bashkë me arsimin e mesëm të ulët katërvjeçar. Në Kosovë ka shkolla fillore me mësim në gjuhën shqipe, serbe, boshnjake dhe turke. (Dali Emrullahu)

SHKOLLA LETRARE. Shkolla letrare shenjon tipologji letrare, të provuar me autorë e vepra që lidhen rreth një rrjeti pikëpamjesh apo një doktrine letrare, të kthyer në praktikë letrare. Shkolla letrare konstituohet me konstantat letrare, si bërthama të shkollave dhe shpërthimet e normave, si bërthama të poetikave personale. Kështu, studimi i letërsisë në bazë të dijes mbi shkollat bëhet në trajtë përshkrimi e interpretimi të tipologjisë letrare dhe jo si histori e prodhimit letrar. Nocioni shkollë letrare, në diskursin teorik e përshkrues, pra historiko-letrar, në letërsinë shqipe del te “Dy shkollat letrare shkodrane” (1954/1961) të Ernest Koliqit, diskurs në të cilën shkolla, në kuptimin e rrymës letrare, shenjon tipologji e shtrirje historiko-letrare. Koliqi skajon: “Shkollën letrare të Françeskajvet” dhe “Shkollën letrare të Jezuitvet” dhe ka kriter temat, stilet e raportet me jetën shqiptare. Shkolla e Françeskajvet lidhet me idiomën e

me temat e vendit dhe kthehet në një letërsi autentike e identitare shqiptare, si te vepra e kreut të saj, Gjergj Fishtës. Ndërsa, kur karakterizohet Shkolla e Jezuitvet, stili bëhet kriter themelor, prandaj ajo shtrihet përtej ambientit të parë, Shkodrës, Veriut dhe Koliqi gjen sivëllezërit letrarë tutje, si te pogradecari Lasgush Poradeci. Termi, konceptet e kërkimi i shkollës letrare rihapet te “Shkollat letrare shqipe” (2004) të Sabri Hamitit, ndërsa kërkimi themelor mbështetet te format e te strukturat letrare, autorët ilustrativë, teoricienët e shkollave dhe figurat (si shenjë e diskurseve). Mbi bazën e vetive të tilla propozohen: Shkolla filobiblike, Shkolla e vjershëtarëve, Shkolla romantike, Shkolla kritike, Shkolla moderne, Shkolla socrealiste, Shkolla disidente, Shkolla moderne (e Kosovës). Viteve të fundit është nënvizuar Shkolla letrare e Prishtinës, si shkollë e dijes letare, praktikë kërkimore e poetike, me burim Universitetin e Prishtinës, që trashëgoi punët themelore të Qarkut të Prishtinës në fushën e mendimit letrar dhe vetë takoi dijet moderne europiane, rihapi traditën shqiptare të kulturës e të letërsisë. (Kujtim M. Shala)

SHKOLLA NORMALE “SAMI FRASHËRI”, PRISHTINË. Shkolla normale-liceale “Sami Frashëri” në Prishtinë u themelua në fund të vitit 1941. Ishte shkolla e parë normale shqipe në trojet shqiptare jashtë Shqipërisë. Kishte tetë klasë (katër të kursit të ulët-gatitor, katër të kursit të lartë). Nxënësit e saj kishin kryer apo vijuar shkolla të ndryshme: qytetëse, semimaturën në gjimnaze serbe, medrese etj. dhe ishin nga të gjitha trevat shqiptare, shumë prej të cilëve u vendosën në konviktin e shkollës. Mësimdhënësit ishin kryesisht nga Shqipëria, por edhe nga Kosova. Drejtori i parë i saj ishte dr. Rexhep Mitrovica, pastaj Ahmet Gashi. Në këtë shkollë nxënësit mësonin gjuhë shqipe, gjuhë latine, gjuhë italiane, gjuhë gjermane, histori, gjeografi, matematikë, shkencat natyrore, pedagogji, didaktikë, vizatim, muzikë, bujqësi, edukatë morale dhe kulturë fashiste dhe praktikë pedagogjike. Shkolla Normale e Prishtinës veproi tri vite shkollore. Në vitin e parë shkollor kishte 262 nxënës dhe 78 të tjerë në gatitore, ndërsa në vitin e fundit 1943/44 kishte 464 nxënës. Po në këtë vit u organizuan edhe provimet e pjekurisë për 16 kandidatët e parë. Veç punës mësimore, shkolla organizoi edhe kurse të ndryshme,

ndër të cilët edhe dy kurse pedagogjike (1942 dhe 1943), ku u kualifikuan rreth 200 mësues. Veprimtaria e kësaj shkolle u ndërpre në vitin shkollor 1944/45. (Bajram Shatri)

SHKOLLA NORMALE E PEJËS. Shkolla normale “Ali Kelmendi” e Pejës u themelua në vitin shkollor 1966/67. Si paralele e gjimnazit pedagogjik në këtë qytet u hap qysh në vitin shkollor 1959/60, ku në klasën e parë u regjistruan dy paralele. Veprimtaria e kësaj shkolle vazhdoi deri në vitin shkollor 1976/77. Ndërkohë, paralele të saj u hapën edhe në Istog dhe në Deçan. Në Normalen e Pejës kanë punuar dhe janë arsimuar shumë figura të shquara të arsimit, shkencës, kulturës etj. (Izet Musaj)

SHKOLLA NORMALE, FERIZAJ. Shkolla normale “Zenel Hajdini” në Ferizaj u themelua në vitin shkollor 1961/62. Ishte shkollë e mesme profesionale për përgatitjen e mësuesve të ciklit të ulët të shkollës fillore. Mësimi ishte pesëvjeçar, por organizoi mësim dhe për kualifikimin e mësuesve të pakualifikuar. Kishte paralele me mësim në gjuhën shqipe dhe paralele me mësim në gjuhën serbe. Në këtë shkollë i ndiqnin mësimet nxënës nga rrethi i Ferizajt, të komunave përreth, si dhe nga treva të tjera shqiptare jashtë Kosovës. Për shkak të mungesës së kuadrit mësimor në gjuhën shqipe, fillimisht disa lëndë mësimore për nxënësit shqiptarë u mbajtën në gjuhën serbe. Me kohë u rrit edhe numri i arsimtarëve shqiptarë me kualifikim përkatës. Në vitin shkollor 1966/67 shkolla doli në objekt të ri, me kushte më të mira për punë. Në vitin shkollor 1975/76 kjo shkollë u reformua. Nga Shkolla normale “Zenel Hajdini” në Ferizaj dolën 13 gjenerata normalistësh të diplomuar. (Nijazi Zylfiu)

SHKOLLA NORMALE, GJAKOVË. Shkolla normale “Hysni Zajmi” në Gjakovë u themelua në vitin 1946, me mësim në gjuhën shqipe. Për shkak të nevojës së madhe për mësues, Normalja e Gjakovës punoi me programe të reduktuara (katër klasë për dy vjet). Në vitin 1953 ajo transferohet në Prishtinë. Në vitin 1960 u vendos që në Gjakovë të hapet sërish shkolla normale, e cila veprroi deri në vitin shkollor 1977/78, kur u shndërrua në akademi pedagogjike me mësim gjashtëvjeçar.

Kontribuoi për përgatitjen e kuadrit mësimor të shkollës fillore, jo vetëm në Gjakovë me rrethinë, por edhe më gjerë. (Demë Hoti)

SHKOLLA NORMALE, GJILAN. Shkollë e mesme profesionale për përgatitjen e mësuesve të mësimit klasor. Si shkollë e pavarur u themelua në vitin shkollor 1958/59. Paralelet e para të saj në kuadër të gjimnazit “Zenel Hajdini” në këtë qytet u themeluan qysh në vitin shkollor 1955/56. Në shkollë fillimisht u regjistruan nxënës të përkatësisë kombëtare shqiptare, ndërsa nga viti shkollor 1959/60 filloi edhe një paralele me mësim në gjuhën serbe. Ishte shkollë e mesme profesionale me mësim pesëvjeçar, për përgatitjen e mësuesve të mësimit klasor. Veprimtarinë e saj e vazhdoi deri në vitin shkollor 1974/75. Në vitin vijues u shndërrua në akademi pedagogjike. (Januz Dervodeli)

SHKOLLA NORMALE, MITROVICË. Shkolla Normale “Hasan Prishtina” në Mitrovicë u themelua në vitin 1967 për përgatitjen e kuadrit arsimor për shkollën fillore. Paralelen e parë për mësues në Mitrovicë e hapi Normalja e Prishtinës në vitin shkollor 1954/55, në kuadër të gjimnazit të këtij qyteti. Në periudhën 1961-1967 nxënësit në këtë shkollë kanë kryer katër klasat e para, ndërsa të pestën e vazhdonin në Normalen e Prishtinës, ku edhe diplomonin. Pas pavarësisë më 1967, në këtë shkollë u përgatitën dhe u diplomuan mësues nga Kosova dhe nga trevat e tjera shqiptare. (Afërdita Kumnova-Mulla)

SHKOLLA NORMALE, PRIZREN. Shkollë e mesme profesionale për përgatitjen e mësuesve të mësimit klasor, me mësim katërvjeçar (nga vitit shkollor 1955/56 pesëvjeçar). Themelohet në Prishtinë, më 1945, ndërsa në vitin shkollor 1947/48 bartet në Prizren. Fillimisht ishte me mësim në gjuhën serbokroate, ndërsa prej vitit shkollor 1955/56 fillon mësimi edhe në gjuhën shqipe. Në vitin shkollor 1956/57 suprimohet Shkolla Normale e Gjakovës dhe një numër i nxënësve të saj transferohet në Normalen e Prizrenit. Në kuadër të Normalës së Prizrenit prej vitit shkollor 1954/55 veprroi edhe shkolla normale e amvisërisë, në vitin 1954 u organizua kursi veror për kualifikimin e mësuesve shqiptarë dhe më 1967 kursi veror për rikualifikimin e mësuesve shqiptarë dhe

serbë nga Kosova, Mali i Zi dhe Serbia. Në vitin shkollor 1973/74, Normalja e Prizrenit shndërrohet në Akademi Pedagogjike. (Riza Brada)

SHKOLLA SHQIPE E DJEMVE NË PRIZREN. Shkolla e parë kombëtare shqipe në Kosovë, që fillimisht ishte shkollë katolike në gjuhën italiane. Për mësimin shqip në shkollat e Prizrenit u angazhuan argjipeshkvët shqiptarë Andrea dhe Pashk Trokshi. Laicizmi dhe kombëtarizimi i kësaj shkolle u intensifikua në vitin 1889, nën drejtimin e Mati Logorecit. Për shkak të kontradiktave dhe interesave të ndryshme të fuqive të mëdha dhe atyre të Ballkanit, historia e kësaj shkolle është shumë e ndërlikuar. Pas vitit 1900 shkolla e djemve e Prizrenit u nda në dysh: nga njëra anë shkolla shqipe nën mbikëqyrjen e konsullatës austro-hungareze me mësues Lazër Lumezin dhe nga ana tjetër, vazhdoi punën shkolla e parë nën drejtimin e Mati Logorecit, e cila u quajt "shkolla e popullit t'atyne pa kishë". Fillimisht tekstet shkollore kopjoheshin me dorë. Luajti rol të rëndësishëm në arsimin shqip në Kosovë. (Fahri Buçinca)

SHKOLLA SHQIPE E JANJEVËS. Ishte ndër shkollat e para katolike shqipe në Kosovë, e themeluar në vitin 1665. U hap me kërkesën e ipeshkvit të Shkupit, Andrea Bogdanit dhe filloi punën në shtëpinë e tij. A. Bogdani hartoi edhe tekstet e para. Me propozimin e tij, mësues në këtë shkollë më 1665 u caktua Pjetër Mazreku, i cili sapo kishte kryer studimet në kolegjin ilirik të Loretos në Itali. Shkolla hasi në vështirësi të shumta nga autoritetet osmane, por luajti rol prijës në arsimin shqip në Kosovë dhe në historinë e arsimit shqip në përgjithësi. (Fahri Buçinca)

SHKOLLA SHQIPE E STUBLLËS. Ishte ndër shkollat e para katolike shqipe, fillet e së cilës çojnë në vitin 1584, kur rekomandohet hapja e një shkolle të tillë ("in forma di collegio"). Historia e saj del në pah gjithnjë e më shumë në fillim të shek. XVII, krahas me shkollat e tjera simotra në Pejë, Gllogjan, Gjakovë, Landovicë, Prizren, Poçest, Suharekë, Papaz e Janjevë. Kjo shkollë u rihap në vitin 1846, të cilën nga viti 1888 e ndihmoi Austro-Hungaria, si financiarisht, ashtu edhe me tekste. Mësues në atë kohë ishte Bartolome Fantella, por më vonë

edhe Mikel Tarabulluzi etj. U legalizua me ndihmën e Austro-Hungarisë në vitin 1905. (Fahri Buçinca)

SHKOLLA SHQIPE E VAJZAVE NË PRIZREN. Shkolla e parë legale shqipe për vajza në Kosovë, e cila u themelua më 1892, me lejen e autoriteteve osmane. Për themelimin dhe mirëvajtjen e punës së saj dhanë kontribut të veçantë argjipeshkvi i Shkupit, Andre Logoreci, pastaj Pashk Trokshi, Mati Logoreci, Lazër Lumezi, Ndue Bytyçi etj. Në këtë shkollë katolike nxënëset mësonin doktrinën e krishterë, shkrim-lexim, aritmetikë, punëdore, histori, gjeografi etj. Si mësuese në këtë shkollë u shquan motrat Mikelangjela dhe Tereza Çoba nga Shkodra. Shkolla punoi pa ndërprerje deri në vitin 1918. Në vitin 1929 autoritetet jugosllave e shndërruan në shkollë me mësim në gjuhën serbe. (Fahri Buçinca)

SHKOLLA SHQIPE, GJAKOVË (1915-1918). Shkolla fillore shqipe "Skënderbeu" në Gjakovë (1915-1918), në kohën e pushtimit austro-hungarez. E themeluan një grup mësuesish



SHKOLLA SHQIPE, GJAKOVË (1915)

patriotë, kryesisht gjakovarë: Ferid Imami, Ibrahim Fehmiu, Qazim Bakalli, Ibrahim Kolçi, Mon Osa, Isuf Puka, Murat Muhaxhiri, Osman Shaqiri (Mano Shaqja) e Dush Ndoci, të prirë nga Niman Ferizi dhe Sali Morina. Këta kryesisht ishin edhe mësuesit e kësaj shkolle, ndërsa drejtori i parë i saj u caktua Sali Morina. Shkolla ia filloi punën në objektin e ruzhdijes së qytetit. Qëllimi i saj ishte përgatitja e të rinjve për të punuar në administratën në gjuhën shqipe dhe për vazhdimin e arsimit. U shtrua nevoja për përfshirjen dhe regjistrimin e nxënësve, për sigurimin e teksteve dhe hartimin

e plan-programit mësimor. Në vitin e parë në këtë shkollë u regjistruan 340 nxënës. Me përpjekjen e mësuesve u arrit të hapej edhe një paralele e veçantë me 30 vajza. Ndërkohë, në Gjakovë u themeluan edhe dy shkolla shqipe katër klasash me 500 nxënës. Po në Gjakovë u hap edhe një kurs për analfabetë, të cilin në vitin 1918 e vijonin 150 veta, prej 18-40 vjeç. Në vitin shkollor 1917/18 numri i nxënësve arriti në 840. Ndër nxënësit e parë që e kryen shkollën shqipe në Gjakovë ishin: Vehbi Meqa, Isa Dautaga, Selman Riza, Qazim Haraçia, Minip Bokshi, Mazllom Rizvanolli etj. Mësuesit e shkollave shqipe në Gjakovë ndihmuan edhe në themelimin e shkollave shqipe në fshatra dhe qendra të tjera të Kosovës. Shkolla shqipe "Skënderbeu" në Gjakovë, sikurse shkollat e tjera shqipe në Kosovë, pushuan së vepruari pas mbarimit të Luftës së Parë Botërore (1918). (Jusuf Meqa)

SHKOLLAT E LARTA EKONOMIKE. Institucione të arsimit të lartë, me studime dyvjeçare, për përgatitjen profesionale të kuadrit me kualifikim të lartë ekonomik-komercial. Shkolla e parë e një profili të tillë ishte Shkolla e Lartë Administrative në Prishtinë, e cila u themelua në vitin 1959. Ishte pararendëse e Fakultetit Ekonomik-Juridik të Prishtinës. Ndër këto shkolla rol të veçantë pati Shkolla e Lartë Ekonomike-Komerciale në Pejë, e cila u themelua në vitin 1960. Në këtë shkollë u diplomuan me qindra kuadro me kualifikim të lartë për nevojat e ekonomisë në Kosovë dhe jashtë saj. Veprimi deri në fillim të viteve 2000, kur përfundimisht u shndërrua në Fakultet të Shkencave të Aplikuara të Biznesit (2004). (Dali Emrullahu)

SHKOLLAT E LARTA PEDAGOGJIKE (SHLP). Institucione të arsimit të lartë për përgatitjen profesionale të mësimdhënësve të mësimit lëndor në katër klasat e larta të shkollës fillore tetëvjeçare, me studime dyvjeçare pas shkollës së mesme. E para shkollë e lartë pedagogjike në Kosovë ishte SHLP-ja e Prishtinës, e cila u themelua në vitin 1958. Shkolla të tilla, më pas, u themeluan edhe në Prizren, Gjakovë dhe Gjilan. Mësimi organizohej, kryesisht, në grupe (degë) dylëndore, si p.sh., gjuhë dhe letërsi shqipe, biologji-kimi, histori-gjeografi, bazat e arsimit teknik (BAT) dhe fizik, matematikë-fizikë

etj., me qëllim të arsimit dhe aftësimit profesional të mësimdhënësve për dy lëndë mësimore. Më pas në kuadër këtyre shkollave u hapën edhe degët e mësimit klasor për mësues në klasat e ulëta të shkollës fillore. Këto shkolla luajtën rol të rëndësishëm për përgatitjen e kuadrit mësimor të shkollës fillore, por në mungesë të kuadrit të nevojshëm, edhe të atij për shkollat e mesme në Kosovë dhe jashtë saj. Pushuan së funksionuari në vitin 2002, kur të gjitha shkollat e larta pedagogjike të Kosovës u integruan në kuadër të Fakultetit të Edukimit me seli në Prishtinë. (Dali Emrullahu)

SHKOLLAT E LARTA TEKNIKE. Shkolla të arsimit të lartë dyvjeçar për përgatitjen e kuadrove me kualifikim të lartë për nevojat e ndërmarrjeve xehetare-metalurgjike, teknologjike, energjetike etj. Në vitin 1961 u themeluan dy shkolla të tilla, në Prishtinë dhe në Mitrovicë, ndërsa në vitin 1976 u themelua Qendra e Shkollimit të Lartë në Ferizaj, të gjitha këto me degë dhe profile të ndryshme. Në këto shkolla u arsimuan me qindra kuadro profesionale me kualifikim të lartë nga fusha e veprimtarisë teknike-teknologjike, energjetike, të xehetarisë, metalurgjisë etj. Shkolla e Lartë Teknike e Prishtinës ishte pararendëse e Fakultetit Teknik në Prishtinë, ndërsa Shkolla e Lartë Teknike e Mitrovicës ishte pararendëse e Fakultetit Xehetar-Metalurgjik po në Mitrovicë. Shkolla e Lartë Teknike në Ferizaj në vitin 2004 u shndërrua në Fakultet të Shkencave Teknike Aplikative. (Dali Emrullahu)

SHKOLLAT E LARTA. Shkolla për aftësimin e kuadrove profesionale me kualifikim të lartë të profileve të ndryshëm. Ishin shkolla me studime dyvjeçare, ku mësonin kandidatët që kishin përfunduar shkollën e mesme. Shkolla e parë e lartë në Kosovë ishte Shkolla e Lartë Pedagogjike në Prishtinë, e themeluar në vitin 1958. Shkolla të tilla pedagogjike, më vonë, u hapën edhe në Prizren (1962), në Gjakovë (1967) dhe në Gjilan (1973). Ndërkohë, u themeluan edhe shkolla të tjera të larta: Shkolla e Lartë Administrative në Prishtinë (1959), Shkolla e Lartë Bujqësore në Prishtinë (1960), Shkolla e Lartë Ekonomike-Komerciale në Pejë (1960), Shkollat e Lartë Teknike në Prishtinë, përkatësisht në Mitrovicë (1961), Shkolla e Lartë Teknike në Ferizaj (1976). Këto shkolla ishin pararendëse të shumë fakulteteve, që u

themeluan më vonë në Prishtinë dhe në qendra të tjera. Me një marrëveshje të vitit 1980, të gjitha shkollat e larta që ekzistonin në Kosovë u futën në kuadër të Universitetit të Prishtinës, si njësi të veçanta akademike. Me Ligjin mbi Arsimin e Lartë në Kosovë (2003), arsimit i lartë në Kosovë iu nënshtroa një reformimi të gjithanshëm në frymën e Deklaratës së Bolonjës. (Dali Emrullahu)


SHKOLLAT E MESME EKONOMIKE.

Shkolla profesionale e shkallës së dytë, pas përfundimit të shkollës fillore tetëvjeçare për përgatitjen profesionale të nxënësve në fusha të ndryshme të ekonomisë (kontabilist, komercialist, financier, tregtar etj.) me kualifikim të mesëm dhe për vijimin e studimeve përkatëse. Shkolla e parë e mesme ekonomike në Kosovë ishte Instituti Tregtar Ekonomik në Pejë, i cili u hap në vitin 1946, me mësim në gjuhën serbokroate. Shkollat e mesme ekonomike hapen edhe në qytete të tjera të Kosovës, si në Ferizaj (1955), Gjilan (1958), Prishtinë (1960) etj., me mësim në gjuhën shqipe dhe serbokroate. Në rrjetin e shkollave të mesme në Kosovë në vitin 1990, shkolla të mesme ekonomike kishte në Ferizaj, në Gjakovë, në Gjilan, në Mitrovicë, në Pejë dhe në Prishtinë. Arsimimi ekonomik për profesione të ndryshme u zhvillua edhe në kuadër të disa shkollave të mesme në komuna më të vogla, por jo si shkolla të mesme ekonomike. (Rexhep Osmani)

SHKOLLAT E MESME TE MJEKËSISË.

U themeluan për përgatitjen e kuadrit shëndetësor. Disa syresh nisën nga puna që në vitet e para pas Luftës së Dytë Botërore. Vazhdoi zgjerimi i tyre, krahas masivizimit të mbrojtjes shëndetësore.

Shkolla e mesme e mjekësisë "Dr. Ali Sokoli", Prishtinë: Në vitin 1959/1960, në kuadër të Spitalit të Përgjithshëm të Prishtinës u hap një paralele me 23 nxënës (22 serbë dhe 1 shqiptar). Një vit më vonë merret vendimi për hapjen e shkollës së mjekësisë në Prishtinë. Në vitin shkollor 1960/61 u pranuan 174 nxënës (43 ishin shqiptarë). Mësimi mbahej në gjuhën serbe. Në vitin shkollor 1963/64 filloi mësimi edhe në gjuhën shqipe, me 149 nxënës shqiptarë. Shkolla ndërroi selinë në vitin 1965, u vendos në objektin ku është sot. Në vitin shkollor 1991/1992 pushteti serb e mbylli shkollën për nxënësit shqiptarë



SHKOLLA E MJEKËSISË "ALI SOKOLI" NË PRISHTINË

dhe mësimi vazhdoi në shkolla-shtëpi deri në mbarim të luftës (1999). Deri në vitin shkollor 1991/92 shkolla e kishte emrin "9 Maji", pas këtij viti e merr emrin "Dr. Ali Sokoli".

Shkolla e mesme e mjekësisë "Luciano Motroni", Prizren: U themelua në kuadër të gjimnazit "Jovanka Radojeviq-Kica" në vitin 1962, drejtimi infermieri. Në vitin 1964 u bë shkollë e pavarur. Nga viti 1970 mori emrin "Ramizi e Boro", drejtime infermieri-mami. Në vitin shkollor 1971/72 u hap drejtimi i farmacisë. Prej themelimit e deri në vitin 1990 procesi mësimor u zhvillua në gjuhën shqipe, serbokroate dhe turke. Në periudhën 1990-1999 mësimi u zhvillua në shtëpi-shkolla dhe po atëherë rimori emrin "Luciano Motroni". Sot mësimi në këtë shkollë zhvillohet në gjuhën shqipe, boshnjake dhe turke.

Shkolla e mesme e mjekësisë "Dr. Xheladin Deda", Mitrovicë: shkolla e parë për infermierë, e cila u hap në vitin 1947 me 32 nxënës, me mësim në gjuhën serbe. Në periudhën 1969-1986 mbajti emrin "Desa Tomanoviq". Në vitin shkollor 1963/64 u hap edhe paralelja e parë në gjuhën shqipe. Në vitin shkollor 1990/91 u larguan nga shkolla nxënësit dhe arsimtarët shqiptarë. Në atë periudhë, ndërsa procesi mësimor zhvillohej nëpër shtëpi-shkolla, shkolla mori emrin "Dr. Xheladin Deda". Objekti i shkollës gjendet në Mitrovicën e Veriut dhe aty ka 25 vjet që nuk mbahet mësimi në gjuhën shqipe. Sot shkolla vazhdon punën në pjesën jugore të Mitrovicës.

Shkolla e mesme e mjekësisë "Hysni Zajmi", Gjakovë: u themelua në vitin 1984. Ka këto profile: infermieri e përgjithshme, pediatri, mami, stomatologji dhe farmaci. Në vitin shkollor 2015/16 vijuan mësimin 921 nxënës.

Shkolla e mesme e mjekësisë, Pejë: u themelua në vitin shkollor 1995/96, me pesë paralele të profileve mësimore: teknik i stomatologjisë, infermier, teknik laborant dhe mami. Në atë vit shkollor vijuan mësimin 241 nxënës. Një vit më vonë u shtua drejtimi teknik i farmacisë dhe u hapën paralelet e ndara në Klinikë dhe Istog. Në vitin shkollor 2002/03 filloi mësimi edhe në gjuhën boshnjake dhe aktualisht mësimi zhvillohet në 18 paralele, nga të cilat 3 në gjuhën boshnjake.

Shkolla e mesme e mjekësisë "Elena Gjika", Ferizaj: u themelua në vitin shkollor 1991/92, si paralele e ndarë e shkollës së mesme të mjekësisë "Dr. Ali Sokoli" të Prishtinës. Në vitin 1994 u themelua si shkollë e mesme më vete, me këto degë: infermieri, stomatologji, mami, pediatri, farmaci, fitnes dhe nutricion dhe laborant i biologji-kimisë. Aktualisht mësimi vazhdon në po ato degë profesionale.

Shkolla e mesme e mjekësisë "Asllan Elezi", Gjilan: nisi punën në vitin shkollor 1994/95. Sot ka 30 paralele me 1,503 nxënës, me të gjitha profilet mjekësore, ndërsa në procesin e mësimdhënies janë të angazhuar 65 mësimdhënës. (Isuf Dedushaj)

SHKOLLAT E MESME TEKNIKE. Shkolla të mesme profesionale për përgatitjen e kuadrit teknik për degë të ndryshme të prodhimit, të shërbimeve dhe veprimtarive shoqërore, si dhe për studime përkatëse. Shkolla e parë e mesme teknike në Kosovë u hap në vitin 1946 në Mitrovicë për përgatitjen e teknikëve të makinerisë dhe të industrisë në kombinatin "Trepça". Pasonjë shkolla të mesme teknike në të gjitha qendra e mëdha komunale të Kosovës (Prishtinë, Pejë, Gjakovë, Prizren, Gjilan, Ferizaj, pastaj në Istog, Skënderaj, Suharekë, Kamenicë, Podujevë etj.). Ato ishin të ndryshme, si: shkolla teknike industriale, të ndërtimitarisë, të komunikacionit dhe të xehetarisë. Mësimi ishte 3 dhe 4-vjeçar. Plani dhe programi mësimor përbëhej nga lëndë të përgjithshme, lëndë të përgjithshme profesionale dhe lëndë të ngushta profesionale që lidheshin me mësimin praktik. Deri në fillim të viteve 1960 mësimi ishte vetëm në gjuhën serbokroate edhe për nxënësit shqiptarë. Mësimi në gjuhën serbokroate për lëndët profesionale do të vazhdojë edhe në vitet vijuese. Si rezultat i reformës në arsim degët teknike vepronë në kuadër të shkollave

të tjera të mesme, në qendra shkollore. (Rexhep Osmani)

SHKOLLAT E MESME TË BUJQËSISË. Shkolla të mesme profesionale për përgatitjen e kuadrit për degë të ndryshme të bujqësisë dhe për studime përkatëse. Në vitin 1945 u hap Shkolla e Ulët e Bujqësisë në Pejë, me mësim 1 dhe 2-vjeçar, për aftësimin e pemëtarëve, lavëtarëve, vreshtarëve etj. Shkollat e para të mesme të bujqësisë u hapën në Prishtinë (1946), në Gjilan (1947), në Pejë (1957) etj. Ishin shkolla katërvjeçare dhe përgatitnin të rinjtë për profesione bujqësore: lavërtari, blegtori, pemëtari, vreshtari, mekanik makinash bujqësore, teknik bujqësie, teknik veterinarie etj. Nxënësit ishin kryesisht serbë. Numri i nxënësve shqiptarë ishte shumë i vogël. Shkollat kishin edhe ekonominë, edhe infrastrukturën e tyre, ku nxënësit kryenin praktikën profesionale. Procesi mësimor fillimisht ishte në gjuhën serbokroate, pastaj edhe në gjuhën shqipe. Mësimi në gjuhën serbokroate, kryesisht për lëndët e ngushta profesionale në paralelet shqiptare vazhdoi deri në vitet 1970. Nga mesi i viteve '70, shkollat e mesme bujqësore shndërrohen në qendra shkollore të fazës së dytë të arsimit të mesëm të orientuar. Më pas shkollat bujqësore u reformuan. Tani ekziston vetëm shkolla e mesme e bujqësisë në Prishtinë, si shkollë bujqësore e mirëfilltë, ndërsa në qendra të tjera programet e arsimit bujqësor realizohen në kuadër të shkollave të tjera. (Rexhep Osmani)

SHKOLLAT E NXËNËSVE NË EKONOMI. Shkolla për përgatitjen e punëtorëve të kualifikuar. Në vitin shkollor 1945/46 shkolla të tilla u hapën në qytetet kryesore të Kosovës: në Mitrovicë, Pejë, Prizren, Prishtinë, Gjakovë, Ferizaj, Vushtrri dhe Gjilan, më pas edhe në vende të tjera. Deri në vitin 1952 vepruan 14 shkolla të tilla në Kosovë. Fillimisht ishin shkolla të ulëta (1, 2 e 3-vjeçare), ku vijonin mësimin nxënësit që kishin të kryer ndonjë klasë të shkollës fillore, ndërsa nga viti 1950 nxënësit që kishin mbaruar së paku katër klasë të shkollës fillore. Nxënësit kishin mësim teorik, i cili zhvillohej në objektet e shkollës, dhe punë praktike, e cila organizohej në njësi punuese apo te mjeshtrit privatë. Mësimi ishte në gjuhën amtare. Personeli mësimor, kryesisht, ishte i angazhuar në punë plotësuese.

Mësimi organizohej pasdite, ndaj quheshin edhe shkolla të natës. Vijues në këto shkolla ishin edhe të rriturit që përgatiteshin për profesione të ndryshme. Me reformën e vitit 1958, shkollat e nxënësve në ekonomi marrin statusin e shkollave të mesme profesionale. Procesi mësimor organizohet në objekte të shkollave të mesme (ekonomike, teknike etj.), kurse vijuesit aftësoheshin për profesione të shkallës I, II dhe III të përgatitjes profesionale. Shkollat e tilla pushuan së vepruari në vitin 1970. (Rexhep Osmani)

SHKOLLAT MUZIKORE NË KOSOVË.

Shkolla e parë e muzikës në Kosovë u hap në Prizren, më 11 maj 1948, me drejtor kompozitorin Lorenc Antonin. Vitin e parë ishte shkollë e ulët e muzikës dhe kishte gjithsej 48 nxënës. Nga viti 1949 vepronte edhe si shkollë e mesme e muzikës me seksionin teorik. Më 1953 doli brezi i parë i të diplomuarve: E. Berisha, Z. Bashota, Sh. Kazazi, K. Lekaj, S. Gjinali, M. Kaçinari etj. Më pas u hap drejtimi instrumental dhe i solokëndimit. Në këtë shkollë kanë mësuar shumë nga emrat që sot përbëjnë historinë e muzikës kosovare, si: E. Rizvanolli, H. Kasapolli, V. Mjeda, A. M. Koci, F. Beqiri, B. Çela, I. Muçolli, R. Randobrava, Z. Ballata, R. Dhomi, M. Piperku etj. Më 1949 u hap në Prishtinë Shkolla e Ulët e Muzikës, ndërsa më 1963 edhe Shkolla e Mesme e Muzikës. Krahas drejtimeve instrumentale (piano, violinë, flaut, klarinet, kitarë, më pas violonçel, trumbetë, trombon, obo, saksofon) vepron edhe ai i solokëndimit. Po ashtu, nga viti 2000, në kuadër të saj u hap edhe dega e baletit. Nga kjo shkollë dolën pedagogë, kompozitorë, instrumentistë, si: M. Mengjiqi, B. Mulliqi, S. Badivuku, V. Mehmetagaj, A. Gashi, L. Pula, A. Statovci etj, si dhe balerina/balerinë të njohur. Më 14 nëntor 1954 u hap Shkolla e Ulët e Muzikës në Mitrovicë, e cila pas një pauze dyvjeçare (1958-60), rifilloi punën në sajë të angazhimit të pedagogut F. Beqiri, ndërsa më pas edhe si Shkollë e Mesme e Muzikës. Viti 1970 shënon hapjen e Shkollës së Ulët të Muzikës në Gjakovë, e cila më pas u bë dhe Shkollë e Mesme e Muzikës, ku funksionojnë drejtimet instrumentale (piano, kitarë, harqe, frymorë, veglat me goditje) e të solokëndimit. Nga emrat e njohur që kanë mësuar në këtë shkollë përmendim violinistin Sh. Doli dhe pianisten L. Pula. Më 1976 u hap

në Pejë Shkolla e Ulët e Muzikës me 70 nxënës të shpërndarë në seksione instrumentale (piano, violinë, flaut, klarinetë, kitarë dhe fizarmonikë), ndërsa nga viti 2010 vepron edhe si Shkollë e Mesme e Muzikës. Më 1978 u themelua Shkolla e Muzikës në Gjilan, e cila në tetor 1979 pranoi 49 nxënës në seksionin instrumental (piano, violinë, fizarmonikë), ndërkaq më 1997 nisi mësimet brezi i parë i Shkollës së Mesme të Muzikës me drejtimin pedagogjik-artistik. Viti 1996 shënon hapjen e Shkollës së Ulët të Muzikës në Ferizaj, drejtimi instrumental (piano, violinë, kitarë, flaut). Më 1998 nisi punën dhe si Shkollë e Mesme e Muzikës, përkatësisht paralele e ndarë e Shkollës së Mesme të Muzikës të Prishtinës, deri më 2000, kur u pavarësua si shkollë më vete. Më 2011 në Kosovë u hapën dhe dy shkolla të reja muzikore, në Rahovec e Vushtrri, që funksionojnë si shkolla të ulëta të muzikës, me drejtime instrumentale (piano, violinë, kitarë, flaut etj.). (Kristina Palokaj-Perkola)

SHKOLLAT SERBE. Fillet dhe zhvillimi i shkollave serbe në Kosovë lidhet me zhvillimin e shkollave serbe në përgjithësi, në kuadër të Perandorisë Osmane. Shkollat e para ishin ato të manastireve dhe shkollat private. Në vitet 1848-1878 vëmendje e veçantë i kushtohet hapjes së shkollave qytetëse dhe të atyre fillore. Në vend të disa shkollave të manastireve dhe atyre private paraqiten shkollat laike. Në vitin 1871 u themelua shkolla teologjike serbe në Prizren, e cila në vitin 1893 u shndërrua në shkollë fetare për mësues. Në periudhën 1878-1903 shtohet numri i shkollave serbe në Kosovë dhe i nxënësve që i vijonin ato. Midis tyre kishte edhe shkolla për vajza. Në vitet 1903-1912, sidomos në prag të luftërave ballkanike, shkollat serbe në Kosovë shënuan një hap cilësor në aspektin organizativ dhe të pavarësimit të tyre, me ç'rast u miratuan edhe dokumente dhe u formuan institucione profesionale arsimore. Shkollat serbe në Kosovë do të masivizohen pas luftërave ballkanike, me pushtimin e Kosovës nga Serbia dhe Mali i Zi. (Hajrullah Koliqi)

SHKOLLAT SPECIALE. Shkolla për fëmijë me nevoja të veçanta, të organizuara sipas llojit të dëmtimit. Shkolla të tilla në Kosovë u themeluan qysh në vitet '50 të shekullit të kaluar. Ekzistonin shtatë shkolla të tilla, në

Prishtinë, Pejë, Prizren, Shtime dhe Mitrovicë, në të cilat përfshiheshin nxënës me prapambetje mendore, dëmtime në të parë, dëmtime në të dëgjuar, vështirësi në komunikim, vështirësi emocionale dhe në sjellje etj. Nga vitit 2006 këto shkolla kanë filluar të transformohen në qendra burimore, të cilat përveç punës me fëmijë me nevoja të veçanta ofrojnë shërbime edhe për shkollat e rregullta për nxënës të integruar në klasa të bashkëngjitura ose në klasa të rregullta. (Naser Zabeli)

SHKOLLAT TURKE-OSMANE. Zunë fill në shek. XV, pranë xhamive dhe teqeve. Të tilla ishin mejtepet dhe medresetë, ndër të cilat u shquan edhe medresetë në Gjakovë, Pejë, Prizren etj. Rol të rëndësishëm arsimor dhe kulturor luajtën edhe teqetë. Interesimi i administratës osmane për reformimin dhe ngritjen e cilësisë së arsimit u rrit, sidomos në fillim të shek. XIX, kur u ndërtua edhe sistemi shkollor publik turko-osman, me shkolla fillore (iptidaie), të mesme të ulët, qytetëse (ruzhdie), gjimnaze (idadie), normale (dar ul-mualimin) etj. Rëndësi të veçantë pati ligji i vitit 1869, sipas të cilit sistemi shkollor turk përbëhej nga shkollat popullore (Sibjan mektepleri), shkollat e mesme (Ruzhdie mektepleri), licetë (Idadiye mektepleri), sulltanie (Sultanie mektepleri) dhe shkollat e mëdha (Mekjatib-i alije). Shkolla të tilla, sidomos fillore, u themeluan edhe në Kosovë. Vetëm në Prizren në vitin 1886 kishte 17 shkolla të tilla për djem dhe 9 shkolla për vajza dhe një ruzhdie (gjimnaz i ulët). Në fund të shek. XIX u themeluan edhe dy shkolla normale turke, në Manastir dhe në Shkup. Në shkollat shtetërore turko-osmane, sikurse edhe në mejtepe dhe medrese në Kosovë u arsimuan kryesisht fëmijët dhe të rinjtë shqiptarë të besimit islam. Kështu, në normalen turke të Shkupit u arsimuan mësuesit kosovarë: Ahmet Gashi, Niman Ferizi, Sadi Pejani, Sali Morina etj. Në ato shkolla dhanë mësim shumë mësues shqiptarë. Sistemi arsimor turko-osman në Kosovë pushoi së vepruari me pushtimin e Kosovës nga Serbia dhe Mali i Zi. Veprimtarinë e tyre e vazhduan kryesisht shkollat fetare islame (mejtepet, medresetë dhe teqetë). (Hajrullah Koliqi)

SHKORRETI Mark Stakë (1869-1944). Argjendar, veprimtar i lëvizjes kombëtare dhe i asaj antikomuniste. Lindi në Prishtinë. Mbajti

lidhje me Hasan Prishtinën, Bajram Currin dhe sheh Mehmet Sezai Efendinë. Për shkak të veprimtarisë atdhetare u ndoq dhe u persekutua vazhdimisht nga pushtuesit serbë, bullgarë dhe jugosllavë. Në vitin 1939 Mbretëria Jugosllave e dënoi me burg, kurse një vit më vonë e internoi në Ivanicë të Serbisë. Ishte anëtar i Komitetit “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës” dhe i Lidhjes së Dytë të Prizrenit. Për shkak të angazhimit të tij kombëtar, më 1943 organizata e Partisë Komuniste të Jugosllavisë në Prishtinë ia vrau nipin 17-vjeçar. Pas përfundimit të luftës dhe pas vendosjes së pushtetit të ri në Kosovë, u arrestua dhe u ekzekutua nga OZN-a në nëntor të vitit 1944, së bashku me shumë antikomunistë dhe kundërshtarë të pushtimit serb të Kosovës. Pas tij u ekzekutuan edhe tre djemtë e tij: Marku, sepse me 17 nëntor 1944, në Janjevë, kishte hequr flamurin jugosllav dhe kishte vendosur atë shqiptar; pastaj Luzi dhe Mikeli, si dhe nipi (djali i Markut), Staka 21-vjeçar. (Muhamet Shatri).

SHKRELI Adem (1936-). Gazetar. Lindi në Shkrel të Rugovës. Shkollën fillore dhe të mesmen i kreu në Pejë. Studioi për drejtësi në Prishtinë dhe gazetarinë në Beograd. Fillimisht punoi në administratë, kurse nga viti 1958, kur “Rilindja” nisi të dalë e përditshme, u bë gazetar i saj. Në këtë gazetë punoi në cilësinë e gazetarit, të redaktorit, komentatorit e të reporterit të lirë. Fushat e interesimit të tij si gazetar ishin hoteleria e turizmi. Bashkëpunoi edhe me mediet e tjera të shkruara shqipe në Prishtinë. Gjatë viteve shkroi me mbiemra të ndryshëm, si Adem Kelmendi, Adem Ujkani, Adem Demaj, Adem Rugova e Adem Shkreli. U mor edhe me letërsi. (Zenun Çelaj)

SHKRELI Azem (1938-1997). Poet, romancier, tregimtar, dramaturg. Lindi në Shkrel të Rugovës, ku kreu shkollën fillore, Shkollën Normale e mbaroi në Prishinë, ku më pas kreu studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në katedrën e albanologjisë të Fakultetit Filozofik të Prishtinës. Në fillim punoi si gazetar në “Rilindje”. Ka mbajtur poste të rëndësishme në fushën e kulturës: kryetar i Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovë, kryetar i Lidhjes së Shoqatave të Shkrimtarëve të Jugosllavisë, drejtor i Teatrit Popullor Krahinor në Prishtinë, themelues dhe drejtor i “Kosovafilmit” etj. Poezitë e para për fëmijë i botoi qysh në



AZEM SHKRELI


vitin 1952, në revistën “Pionieri”. Në fund të këtij dhjetëvjetëshi ai bëri emër me poezi për të rritur. Romanin “Karvani i bardhë” A. Shkreli e shkroi ende si nxënës i shkollës së mesme dhe, i botuar më 1961, ishte vepra e parë serioze e këtij zhanri në prozën shqipe të Kosovës. Personazhi kryesor i saj, në krye të grupeve nacionaliste të përfshirë në luftë kundër aradheve partizane, ishte ndër të paktët deri atëherë, në mos i vetmi, personalitetin e të cilit e mbrojti përmes një diskrecioni elegant dhe të hollë narrativ. Veprat e botuara pëfshijnë përmbledhje me poezi, tregime, roman, drama dhe publicistikë: “Bulzat” (1960), “Karvani i bardhë” (1961), “Engjujt e rrugëve” (1963), “Sytë e Evës” (1965), “Fosilet” (1968), “E di një fjalë prej guri” (1969), “Nga bibla e heshtjes” (1975), “Pagëzim i fjalës” (1981), “Varri i qyqes” (1983), “Kënga e hutinit” (1986), “Nata e papagajve” (1990), “Lirikë me shi” (1994), “Zoti nuk është shqiptar” (1997), “Zogj dhe gurë” (1997). Azem Shkreli është poet i shquar, me talent të madh, që la gjurmë të përhershme në qiellin poetik të shqipes. Lirika e tij refleksive, me ndjeshmërinë dhe ngarkesën e shqetësimit të kohës, historisë shqiptare të Kosovës gjatë dhjetëvjetëshave të fundit të shekullit njëzet është zëri artistikisht i artikuluar fuqishëm. Mjeshtër i fjalës, i shprehjes artistike, i dendësisë së mendimit dhe ndjenjës, poetika e tij është karakteristike, e njohur për eliptizmin origjinal. E thellë në mendime, dramatike në emocione, vizionare në intuitë, estetike në artikulimin e ironisë së hollë, poezia e A. Shkrelit mbetet shkollë frymëzimi në hapësirën e poezisë shqipe. I tillë, me shenjë njohëse për poetikën krijuese të tij, ai është edhe te proza e shkurtër, tek eseja dhe drama dhe sidomos në tekstet të natyrës polemike dhe epistolare. (Ali Aliu)

SHKRELI Beqir (1936-). Gazetar. Lindi në Treboviq të Pejës. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Pejë, ndërsa studimet për gjuhë frënge në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Punoi mësues në shkollat fillore të fshatrave Nakëll, Isniq dhe Katund i Ri të Pejës. Në vitin 1964 filloi punë në gazetën

“Rilindja” dhe aty qëndroi derisa u ndërpre dalja e saj. Gjatë punës si gazetar shkroi lajme, informata, raporte e reportazhe. Bëri edhe një sërë shkrimesh satirike. Gjatë viteve ‘90, pas ndalimit të gazetës “Rilindja”, në gazetën “Bujku” u kujdes për kalendarin historik dhe rubrika të tjera. Është autor i radiodramave “Përplasjet”, “Ankthi” etj. (Zenun Çelaj)

SHKRELI Xhevat (1892-1960). Mësues veteran. Lindi në Pejë, shkollën fillore e mbaroi në vendlindje, ndërsa Medresenë në Shkup. Në vitet 1915-1918 punoi si mësues në shkollat fillore shqipe “Skënderbeu” dhe “Haxhi Zeka” në Pejë. U angazhua edhe në organizimin e kurseve për arsimin e të rriturve, të kurseve pedagogjike dhe për arsimimin e vajzave. Pas Luftës së Parë Botërore e vazhdoi veprimtarinë arsimore në Shqipëri, fillimisht në Shkodër, pastaj në Elbasan, në Krumë të Hasit dhe në Kolgecaj të Malësisë së Gjakovës. Në Pejë u kthye para Luftës së Dytë Botërore, ku vazhdoi punën e mësuesit. Mësues ishte gjithashtu edhe gjatë luftës (1941-1944) dhe pas luftës në Shkollën fillore “Lidhja e Prizrenit” në Pejë, ku punoi për një kohë të gjatë. Për kontributin në fushën e arsimit u nderua me çmime dhe mirënjohje. (Afërdita Deva-Zuna)

SHKRELI Ymer (1945-). Shkrimtar, dramaturg. Lindi në Shkrel të Rugovës. Shkollën fillore e kreu në Haxhaj, Normalen e nisi në Pejë dhe e kreu në Prishtinë, ku vazhdoi studimet për gjuhë dhe letërsi. Një kohë punoi si mësimdhënës në Rugovë, pastaj në Prishtinë. Në periudhën 1968-1993 ishte gazetar e reporter i lirë në “Rilindja”. Ishte redaktor i “Rilindjes për fëmijë”, kryetar i Rinisë Letrare



YMER SHKRELI

të Kosovës dhe kryeredaktor i revistës “Plejada”, e ndaluar pas numrit të gjashtë. Bashkëpunoi me revistën “Thumbi”. Është ndër autorët që fitoi shumë çmime edhe në konkurset letrare anonime. Ka botuar vepra dhe punime letrare nga të gjitha gjinitë dhe zhanret letrare e publicistike. Pjesë nga vepra e tij janë përkthyer në gjuhë të ndryshme, të përfshira në antologji e panorama letrare. Nga viti 1993 jeton në Lucern të Zvicrës. Ka botuar librat për fëmijë:

“Hana po shkon nuse” (1969), “Princesha e Dukagjinit” (1970), “Kthema pranverën time” (1972), “Princi i Bjeshkëve të Nemuna” (1975), “Bali Katravella” (1978), “Ditari i Lec Pazhecit” (1979) dhe “Autobiografia” (1990). Botoi librat me poezi: “Ditari i hajnit” (1971), “Romanella” (1974), “Febris” (1975), “Kërkoj dënim me vdekje” (1978) dhe “Balcanica” (1980); pastaj romanet: “Vjeshta e vdekur” (1971), “Hi e pluhur” (1971-1972), “Njeriu në bisht” (1975), “Vdekja në ajër të pastër” (1976), “Pikëpjekja” (1982), “Rapsodi kosovare” (Kali i Trojës, Heroi në gjumë, Shpendkeqja, Zeka i Zi, 1986), “Doracak për tjetër botë” (1986), “Ura e Xhehnemit” (1989) dhe “Azgal” (1993); pastaj dramet: “Alter Ego” (1969), “Hotel Kashta” (1975), “Trilogji ilire” (Agroni, Teuta, Genci, 1977); “Krrasin sorrat mbi qytet” (1978), “Meshari” (1978) “Shturja” (1982), “Zeka i Zi udhëton për në Babilon” (1984), “Teatri Plak” (No pasaran, Roja e shiut, Nëna shkon në parajsë, Teatri i vogël i Deli Ukës, 1987), “Trilogjia e Re” (Ulpiana 518, Shpend Sokoli i Sokol Shpendit, Paradoksi, 1990), “Heronjtë e kombit” (1993), dhe “Shqiptari me duar në xhepa” (1996). Ka shkruar edhe radiodrama, skenarë për film e televizion etj. (Shaip Beqiri)

SHKRELI. Fshat malor në komunën e Pejës, në brezin kufitar ndërmjet Kosovës dhe Malit të Zi. Ndodhet ndërmjet vendbanimeve Bogaj dhe Koshutan në lartësinë mbidetare 1,600 m. Dikur ishte vendbanimi më i madh i Rugovës, por tani i boshatisur, ngase banorët u shpërngulën në Pejë, Istog etj. Ishte zonë e njohur blegtorale me etnografi dhe jetë sociale karakteristike. Se ishte vendbanim i lashtë dëshmohet nga themelet e disa objekteve të vjetra, që janë gjendur në këtë zonë. Si vendbanim haset edhe në sallnamet e vilajetit të Kosovës të vitit 1893 me 1,311 banorë, ndërsa në vitin 1900 Shkreli kishte 1,318 banorë. (Përparim Gashi)

SHKRIMI I SHQIPES ME ALFABET ARAB. Krijimtari letrare e cila lindi si rrjedhojë e zhvillimit ekonomik, politik dhe kulturor gjatë periudhës së qeverisjes osmane në hapësirat shqiptare. Gjurmët e para të shkrimit të shqipes me alfabet arab datojnë nga fundi i shek. XVII, për të marrë hov sidomos në shek. XVIII dhe në fillim të shek. XIX. Alfabeti arab vazhdoi të përdoret në Kosovë deri në

vitin 1947. Përfaqësuesit më eminentë, të cilët shkruan shqip me alfabet arab, janë: Nezim Frakulla, Sylejman Naibi, Hasan Zyko Kamberi, Muhamet Kyçyku, Tahir Efendi Boshnjaku, Hafiz Ali Ulqinaku, Rexhep Vokë Tetova, Sheh Hilmi Maliqi etj. Nën ndikimin e mjedisit ku u arsimuan dhe u edukuan, autorët e kësaj letërsie përdorën në veprat e tyre një gjuhë të ngarkuar me orientalizma. Gjurmët e kësaj krijimtarie konsiderohen ndihmesë për një pasqyrë më të plotë të historisë së letërsisë shqipe dhe historikut të shkrimit shqip. Kontribute me vlerë në këtë fushë kanë dhënë: O. Myderrizi, H. Kaleshi, I. Ajeti, M. Hysa, R. Elsi, A. Hamiti, I. Memishi etj. (Jahja Hundozi)

SHKUPI Jashar bej (1860-1919). Veprimtar i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. I përkiste familjes shqiptare të Kumbarajve, e cila ishte e njohur në krahinën e Shkupit dhe më gjerë. Që në moshën 18-vjeçare mori pjesë si delegat i sanxhakut të Shkupit në Kuvendin Themelues të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe u zgjodh kryetar i degës së Lidhjes për sanxhakun e Shkupit. U rreshtua përkrah grupimit autonomist të Lidhjes dhe u angazhua për jetësimin e vendimeve të Kuvendit të Dibrës, për hapjen e shkollës së parë në gjuhën shqipe në Shkup në fund të vitit 1878. Ishte protagonist kryesor në ngritjen e gjykatës shqiptare të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në sanxhakun e Shkupit. Po ashtu u priu forcave të armatosura të degës së Lidhjes më 4 dhjetor të vitit 1880, duke penguar hyrjen e forcave ushtarake osmane në Shkup. Kjo ngjarje shënoi edhe çlirimin e Shkupit nga forcat e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Me këtë rast J. Shkupi mori pozitën e prefektit të Shkupit dhe administratën osmane e zëvendësoi me atë të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Më 1981 u burgos nga forcat ushtarake osmane dhe u dërgua për të vuajtur dënimin në kështjellën e Rodosit. Në vitin 1919 vdiq në Stamboll. Aktivitetin e tij atdhetar e vazhdoi djali i tij, Emin bej Kumbara, i cili ishte delegat i Klubit “Bashkimi” të Shkupit në Kongresin e Manastirit në vitin 1908. (Skënder Asani)

SHKUPI Shefqet (1883-1953). Ushtarak, veprimtar i lëvizjes nacionaliste. Lindi në Shkup. Arsimin fillor e mori në Selanik. Ndoqi shkollën e lartë në Akademinë Ushtarake Turke dhe më pas Akademinë e Shtabit të Përgjithshme në Stamboll

(1905). Shërbeu në funksione të ndryshme në ushtrinë osmane. Mbështeti lëvizjen e Turqve të Rinj, duke qenë pjesë e njësiteve ushtarake të cilat sulmuan Stambollin (1908). Në qeverinë e Vlorës ishte pjesë e Ministrisë së Luftës. Propozoi shërbimin e detyrueshëm ushtarak. Mbahti poste të larta ushtarake në Qeverinë e Princ Vidit. Në janar të vitit 1920 nga Qeveria Shqiptare caktohet komandant i Komandës së Përgjithshme dhe më vonë shef i Shtabit të Përgjithshëm. Mbështeti Hasan Prishtinën dhe kryengritjen e qershorit të vitit 1924. Në regjimin e Zogut burgoset (1935). Ishte aktiv gjatë Luftës së Dytë Botërore, kundërshtar i pushtimit Italian dhe atij gjerman. Emërohet komandant i Zonës së Karadakut në tetor të vitit 1944 nga udhëheqja e lartë e Lidhjes së Dytë të Prizrenit. Vdiq në Shkodër. (Ili Zylfiu).

SHKUPI Valihi (-1599). Poet, epigrafist. Lindi në Shkup në çerekun e parë të shek. XVI. U shqua me pseudonimin poetik "Valihi", ndërsa emrin e vërtetë e kishte Ahmed. Mësimet e para i mori në vendlindje, ndërsa studimet i vijoi në Stamboll. Punën praktike e bëri në Medresenë e sulltan Bajazitit në Edrene, pastaj tërë jetën punoi si kadi. U dallua si poet dhe si komentues i veprave në fushën e sufizmit islam. Është autor i një divani dhe i disa mbishkrimeve në objekte të ndryshme të kultit në Kosovë, i mbishkrimit që edhe sot qëndron mbi portën e Xhamisë së Koxha Sinan Pashës në Kaçanik dhe i mbishkrimit të Xhamisë së Hasan Pashës dhe të urës së tij në Rogovë. Pothuaj tërë jetën punoi si kadi në Shkup. Vdiq në Shkup dhe u varros në tyrben e Kalasë së Shkupit. (Nehat Krasniqi)

SHLLAKU Hasan (1835-1916). Myderriz, myfti, kadi, veprimtar i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Lindi në Gjakovë. Mësimet e para i mori në Medresenë e Madhe të Gjakovës, kurse studimet për drejtësi i vazhdoi në Universitetin e Stambollit. Ka qenë kadi në gjykatën e lartë perandorake. Me përkrahjen e Hoxhë Tahsinut u angazhua si profesor në Fakultetin e Jurisprudencës në Universitetin e Stambollit. Rreth vitit 1877 u kthye në vendlindje dhe u emërua myderriz në Medresenë e Madhe dhe myfti i Gjakovës. Ka qenë deputet i Gjakovës në Parlamentin Osman. Ishte njëri ndër veprimtarët kryesorë të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. U shqua për

idetë politike të moderuara ndër shqiptarët dhe pati rol kryesor në zhvillimet politike në vend. Derisa Riza bej Gjakova ishte i internuar në Halep, në bashkëpunim me të, organizuan një kryengritje, e cila u dekonspirua dhe u shua nga pushteti osman. Ishte person me ndikim në Gjakovë dhe rrethinë. Është autor i disa teksteve nga fusha e jurisprudencës islame. (Nehat Krasniqi, Sadik Mehmeti)

SHLLAKU Marie (1922-1946). Veprimtare e lëvizjes antikomuniste. Lindi në Shkodër, ku kreu shkollimin fillor dhe të mesëm. Studimet për filozofi i filloi në Universitetin e Romës më



MARIE SHLLAKU

1941, por i ndërpreu për shkaqe ekonomike. Pas kthimit në atdhe punoi në Tiranë në kabinetin e ministrit të qeverisë proitaliane, Ilaz Agushit. U angazhua legalisht për realizimin e projektit të bashkimit kombëtar të shqiptarëve. Mbante lidhje edhe me Misionin Anglez në Shqipëri. Në shkurt të vitit 1943 u emërua nëpunëse në degën e Ministrisë së Financave në Prizren, ndërsa një kohë të shkurtër shërbeu edhe në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Gjatë qëndrimit në Kosovë kishte vënë lidhje me personalitete të shquara të lëvizjes së rezistencës antikomuniste, të Lëvizjes Nacional Demokratike Shqiptare (LNDSH) dhe të "Besës Kombëtare". Mori pjesë në strukturat udhëheqëse të Lidhjes së Dytë të Prizrenit dhe të LNDSH-së. Ishte pjesëmarrëse dhe procesmbajtëse në Kuvendin e Dobërdolit të Klinës. Në betejën e Siçevës të 12 shtatorit 1945 u plagos, por nuk u dorëzua dhe vazhdoi luftën kundër njësiteve ushtarake jugosllave. Më vonë u arrestua. Pas shumë torturave dhe vuajtjeve në burgjet e OZNA-s, në një proces gjyqësor në Gjykatën e Prizrenit u dënua me vdekje dhe u pushkatua më 24 nëntor 1946 në Prizren. Nuk i dihet varri. (Haki Kasumi).

SHMIT Oliver Jens (Oliver Jens Schmitt) (1973-). Historian. Lindi në Bazel të Zvicrës. Studioi bizantinistikë, neogrecistikë dhe histori të Europës Lindore në Bazel, Vjenë, Berlin dhe Mynih. U diplomua më 1997 dhe u doktorua më 2001 në Mynih. Në vijim bëri studime të specializuara në Venecie. Në periudhën 2001-



OLIVER JENS SHMIT

2004 qe mësimdhënës në Institutin për Histori të Europës Lindore dhe Juglindore të Universitetit të Munihut. Pas habilitimit në Universitetin e Regensburgut, në vitet 2004-2005 punoi si profesor në Universitetin e Bernit, ndërsa nga viti

2005 është profesor për histori të Europës Juglindore në Universitetin e Vjenës. Në vitin 2009 u zgjodh anëtar korrespondent i Akademisë Austriake të Shkencave, ndërsa nga 2011 anëtar i rregullt i saj. Në vitet 2010-2014 ishte drejtues i Institutit të Historisë Lindore në Universitetin e Vjenës. Është anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Është drejtues i fushës së hulumtimeve ballkanologjike në Institutin për Hulumtimet e Historisë së re të Akademisë Austriake të Shkencave. Në studimet e tij O. Shmit është përqendruar kryesisht në historinë shoqërore dhe ekonomike të mesjetës, në proceset e transformimit socio-ekonomik dhe kulturor në hapësirat në jug të Danubit në fund të shekullit XVII, në hapësirën kulturore veneciane në Europën Juglindore etj. Ka bërë hulumtime për historinë shqiptare, përfshirë Kosovën dhe Maqedoninë. Ndër veprat e tij me rëndësi dhe për studimet shqiptare dallohen: “Arbëria venedike 1392-1479” (2001, shqip 2007), “Levantinët - Botëkuptime dhe identitete të një bashkësie etnokonfesionale në Perandorinë Osmane në shek. XIX” (2005), “Kosova - Histori e shkurtër e një treve qendrore ballkanike” (2008, shqip 2012), “Skënderbeu - Aleksandri i ri nga Ballkani” (2008, 2009, rumanisht 2014), “Shqiptarët. Një histori midis Lindjes dhe Perëndimit” (shqip 2012), pastaj veprën “Europa Juglindore dhe Adriatiku në Mesjetën e vonë (2012), bashkë me Gruber dhe Lutter, “Historia kulturore mesjetare: burime dhe metoda për historinë Mesjetës”. Njihen veprat kolektive që ai ka botuar bashkë me K. Kleving për Europë Juglindore (2005), për historinë e Europës Juglindore, për historinë shqiptare, për lidhjet e Venedikut me Adriatikon lindor, për rajonet e Europës dhe historitë e tyre, për pushtimin osman të Ballkanit dhe një numër artikujsh e studimesh nëpër revista të ndryshme, në një pjesë të të cilëve merret me çështje të historisë shqiptare dhe të Ballkanit. (Rexhep Ismajli)

SHOQATA (LIDHJA) E SHKRIMTARËVE TË KOSOVËS. Asociacion i krijuesve letrarë të Kosovës, i themeluar me vendimin e Lidhjes së Shkrimtarëve të Jugosllavisë, më 30 tetor 1970, ndërsa prej vitit 1965 e deri në pavarësimin e saj ishte si seksion i Shoqatës së Shkrimtarëve të Serbisë. Kryetar i parë i Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës ishte poeti dhe studiuesi Mark Krasniqi, ndërsa i fundit përdërisa e mbante këtë emër (deri në përfundim të luftës së Kosovës) ishte studiuesi i letërsisë, Ibrahim Rugova. Ka dhënë çmimet vjetore, si atë për librin më të mirë të vitit (në të gjitha gjinitë dhe llojet), i cili në vitet '90 mori emrin e Pjetër Bogdani, pastaj çmimin “Hivzi Sulejmani” për librin më të mirë në prozë, si dhe çmimin e Mitingut të Poezisë në Gjakovë për librin më të mirë të poezisë. Pas luftës së Kosovës (1999), Shoqata e Shkrimtarëve të Kosovës riemërohet Lidhja e Shkrimtarëve e Kosovës, e cila mori statusin e asociacionit të lirë të shkrimtarëve të Republikës së Kosovës, që kultivon vlerat letrare artistike dhe emancipon jetën kulturore. Asociacioni organizon manifestime letrare, tryeza dhe tribuna, orë letrare, ligjërata, përrurime librash dhe përvjetorë. Asociacioni jep çmimin letrar “Esad Mekuli” për veprimtari letrare të shkrimtarit dhe çmimin “Metafora”, që ndahet në kuadër të festivalit “Drini poetik”. (Ragip Sylaj)

SHOQATA “ART CLUB”, ULQIN. Shoqatë e krijuesve në Ulqin, e themeluar në vitin 1990. Gjatë kësaj periudhe bëri promovimin e kulturës, të letërsisë, të artit dhe të shkencës shqiptare në Mal të Zi. “Art Club” botoi mbi 100 libra, shumicën të autorëve shqiptarë nga Mali i Zi. Shoqata organizon manifestimin letrar “Kalimera poetike” në Ulqin, qysh nga viti 1993. Në kuadër të kësaj veprimtarie janë organizuar mbremje autoriale kushtuar shumicës së shkrimtarëve më të njohur shqiptarë, poetëve e shkrimtarëve nga rajoni dhe më gjerë. “Art Clubi” ka organizuar edhe disa konferenca shkencore, siç ishte ajo për “Mesharin” e Gjon Buzukut (1995), për historinë e Ulqinit (2000), për Ymer Prizrenin (2002), për pozitën e gjuhës shqipe në Malin e Zi (2009) etj. Shoqata botoi revistën “Fati”, revistën për fëmijë “Zana” dhe revistën për shkencë, art e kulturë “Lemba”. “Art Clubi” ishte një nga themeluesit e Panairit të Librit në Ulqin (2001), të Teatrit alternativ, organizoi “Ditët e filmit shqiptar” dhe veprimtari të tjera.

Shoqata ndan çmimin për art, kulturë dhe shkencë, të cilin deri më tash e kanë marrë emra të njohur në fushë të letërsisë e arteve të tjera. (Haxhi Shabani)

SHOQATA “MOTRAT QIRIAZI”. Shoqatë për zhdukjen e analfabetizmit, e themeluar më 1990 në Samadraxhë, Suharekë, me moton “Me laps në Europë”. Kishte 32 degë në Kosovë, veprimtaria e të cilave u shtri edhe në Zvicër, Suedi, Maqedoni, Mal të Zi, Gjermani dhe në SHBA. Veprimtaria e kësaj shoqate, ndonëse në kushte të vështira, u intensifikua në rrethanat e masave të dhunshme të pushtetit serb në arsimin e Kosovës (1990-1999). Gjatë kësaj periudhe veprimtarët e Shoqatës “Motrat Qiriazit” bënë punë të mirë për zhdukjen e analfabetizmit, sidomos për arsimimin dhe emancipimin e vajzave dhe të grave në zonat rurale të Kosovës dhe më gjerë. (Sabit Jaha)

SHOQATA BAMIRËSE HUMANITARE “BEREQETI”. Shoqatë e Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK) për veprimtari humanitare, bamirëse dhe sociale. Është vazhdimësi e aktiv-



NGA NJË AKTIVITET I SHOQATËS BAMIRËSE “BEREQETI”

iteteve humanitare në përkrahje të popullit dhe të lëvizjes së rezistencës popullore të Kosovës që nga vitet ‘90 të shekullit të kaluar, ndërsa gjatë viteve të luftës 1998-1999 ka vepruar si Këshill i Emergjencës së Bashkësisë Islame të Kosovës. Po ashtu atë kohë Këshilli i Emergjencës i BIK-ut kishte ndihmuar edhe njësitë e UÇK-së, si me ushqime ashtu edhe në logjistikë. Si Shoqatë humanitare e bamirëse “Bereqeti” është regjistruar më 2001. Gjatë viteve të para të pasluftës ka zhvilluar aktivitet të dendur në përbalimin e gjendjes emergjente në të cilën gjendej popullsia e Kosovës, ndërsa pas fazës

emergjente Shoqata “Bereqeti”, në bashkëpunim me partnerë dhe donatorë dhe me njerëz të vullnetit të mirë, ka realizuar një sërë projektesh anekënd Kosovës. Përveç mbështetjes humanitare, “Bereqeti” i ka kushtuar kujdes të veçantë parandalimit të trafikimit me qenie njerëzore, për çka ka zhvilluar një sërë fushatash sensibilizuese, pastaj është angazhuar në promovim e vlerave të paqes, tolerancës dhe mirëkuptimit, në kuadër të dialogut ndërfaqar. Në bashkëpunim me strukturat kompetente shtetërore, kjo shoqatë ka dhënë kontribut të rëndësishëm në ruajtjen e shëndetit publik, e sidomos edukimit dhe arsimimit të atyre që nuk kanë mundësi materiale. Shoqata ka degët e saj në çdo këshill të Bashkësisë Islame përmes të cilëve edhe zhvillon aktivitetin në terren. Selia e Shoqatës “Bereqeti” është në Prishtinë. (Ramadan Shkodra)

SHOQATA E ARTISTËVE APLIKATIVË TË KOSOVËS. Asociacion që organizoi artistët aplikativë të Kosovës, me qëllim intensifikimin e aktivitetit dhe promovimin e vlerave artistike në këtë fushë. Duke qenë se Kosova ka një traditë të pasur të artizanaleve, zhvillimet bashkëkohore bënë që prodhimet unike të mjeshtërive tradicionale të gjejnë zbatim në kushtet e prodhimit të avancuar, duke i përshtatur ato për prodhim serik dhe për përdorim më të gjerë. Mjeshtritë tradicionale të Kosovës, siç ishin filigrani, endja e pëlhurave, endja e qilimave, qëndisja, qeramika, formësimi i metaleve, si bakri, hekuri etj., pastaj drugdhendja, arkitektura e objekteve të banimit dhe enterierët e stilizuara dhe funksionale shërbyen si bazë për autorët në përpjekjet e tyre që prodhimet artizanale t’ua përshtatin kërkesave të kohës dhe shijes bashkëkohore. Me shtimin e vazhdueshëm të numrit të krijuesve dhe me shtimin e aktiviteteve të artistëve aplikativë në Kosovë, u bë imperativ i kohës organizimi adekuat i një asociacioni përkatës, ashtu siç e kishin edhe artistët në hapësirat e tjera të ish-Jugosllavisë. Kështu, më 1972, grupi i artistëve aplikativë, që tashmë kishin kryer studimet në Akademinë e Arteve Aplikative në Beograd dhe në qendrat e tjera u mblodhën në një këshill iniciues që më pas thirri mbledhjen konstitutive të Shoqatës së Artistëve Aplikativë të Kosovës, bërthamën e së cilës e përbënin: Bashkim Fehmiu (arkitekt), Matej Rodiqi (tapicier dhe disenjator grafik),

Blerim Luzha (disenjator i tekstilit), Nuredin Loxha (skenograf), Shyqri Nimani (disenjator grafik), Violeta Xhaferi (kostumografe), Agush Beqiri (arkitekt-enterierist) etj. Kryetar i parë Shoqatës u zgjodh Shyqri Nimani, i cili zhvilloi aktivitetet dhe e afirmoi këtë asociacion të artistëve aplikativë. Përmes kësaj shoqate u realizuan shumë ekspozita kolektive në Kosovë, në të gjitha qendrat e ish-Jugosllavisë, si dhe në botën e jashtme. Me emrin e kësaj shoqate u organizuan edhe një sërë ekspozitash personale në Zagreb, Tiranë, Beograd etj. (Blerim Luzha)

SHOQATA E ARTISTËVE FIGURATIVË TË KOSOVËS. Është asociacioni më i lartë në fushën e arteve pamore në Kosovë, i cili nga themelimi e deri sot ka luajtur rol parësor në organizimin e ekspozitave kolektive, vendore dhe ndërkombëtare. Fillimisht funksiononte si Klubi i Artistëve. Ndër veprimtaritë e para të këtij klubi ishte themelimi i Kolonisë Artistike në Deçan (1958), e cila funksionoi deri në vitet nëntëdhjetë. Në Kongresin e Lidhjes së Shoqatave të Artistëve Figurativë të Jugosllavisë në Zagreb më 1973, me kërkesë të delegatëve nga Kosova, merret vendim për themelimin e Shoqatës së Artistëve Figurativë të Kosovës (SHAFK). Kthesa më e madhe dhe vendimtare vërehet në këtë periudhë, kur rreth Shoqatës tubohen krijues të njohur të dalë fillimisht nga Shkolla e Lartë Pedagogjike dhe më pas nga Akademia e Arteve në Prishtinë. Ndikimi i Shoqatës do të manifestohet edhe në themelimin e Galerisë së Arteve të Kosovës në vitin 1979. Veprimtaria e SHAFK-ut dhe e anëtarëve të saj pasqyrohej në aktivitetet e shumta, sidomos në organizimin e ekspozitave tradicionale, si ajo e Sallonit Pranveror, Ekspozita Vjeshtore, Bienalja e Vizatimit, Salloni i Nëntorit si dhe mbështetja e shoqatave komunale të Kosovës. Një kohë këto manifestime organizoheshin në Foajeun e Teatrit Krahinor, pastaj në Galerinë e Arteve, ndërsa pas mbylljes së institucioneve kulturore nga regjimi serb, në kafë-galeri të ndryshme, si: “Koha”, “Hani i 2 Robertëve” në Prishtinë, pastaj në Galerinë “Rada” në Prizren, “Evergrin” në Pejë etj. (Hivzi Muharremi)

SHOQATA E ARTISTËVE MUZIKORË E KOSOVËS. Asociacion i krijuesve muzikorë të Kosovës, në të cilën bëjnë pjesë profesionistë të shumtë të kësaj fushe, si kompozitorë, këngëtarë, instrumentistë, producentë etj. U

themelua në fillim të viteve '70, me iniciativë të një grupi veprimtarësh muzikorë, krahas me themelimin edhe të festivalit “Skena muzikore e Prishtinës”. Kryetar i parë i shoqatës ishte kompozitori Akil Koci. Qëllimi i këtij asociacioni ishte promovimi përmes paraqitjeve publike të vlerave muzikore, siç janë recitalet, koncertet me instrumentistë, këngëtarë dhe ansamble, me orkestra të ndryshme dhe me vepra kompozitorësh vendorë e të huaj. Pas luftës së fundit në Kosovë, Shoqata e Artistëve Muzikorë rifilloi aktivitetet me koncerte, recitale, festivale, por pa arritur të mbajë vazhdimësinë e punës dhe aktivitetëve. (Zeqirja Ballata)

SHOQATA E FARMACISTËVE TË KOSOVËS (SHFK). U themelua në vitin 1965 në Prishtinë, si degë e Shoqatës së Farmacistëve të Serbisë (SHFS). Kryetar i shoqatës u zgjodh mr. ph. Mahmut Mahmuti, farmacisti më i vjetër, drejtor i barnatoreve të Prishtinës. Kosova atë vit kishte 30 farmacistë të diplomuar nga të gjitha kombësitë. Shoqata bëri punë të mirë në hapjen e barnatoreve të reja për shkollimin e kuadrit dhe për themelimin e Barnatoreve të Bashkuara të Kosovës. Në vitin 1974 u bë shkëputja e SHFK-së nga SHFS-ja. SHFK-ja zhvilloi aktivitetin e saj deri në vitin 1989, kur u suprimua nga organet serbe. Më 1996 u bë riaktivizimi i shoqatës si asociacion i pavarur i farmacistëve të Kosovës. Shoqata luajti rol në periudhën e luftës, duke i furnizuar me barna dhe material sanitar spitalet ushtarake dhe popullsinë civile të zhvendosur nga zonat e luftës. Pas luftës shoqata u angazhua për organizimin e takimeve dhe simpoziumeve profesionale. Në qershor të vitit 2014 u themelua edhe Oda e Farmacistëve të Kosovës me statut dhe ligj të veçantë. (Amir Agani)

SHOQATA E GJEOGRAFËVE TË KOSOVËS. Grupim gjeografësh nga të gjitha viset e Kosovës dhe jashtë saj. U themelua në vitin 1969, rreth 6 vite pas themelimit të katedrës së gjeografisë (1963), në kuadër të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Qëllimi kryesor ishte bashkëpunimi i gjeografëve nga Kosova për zhvillimin dhe avancimin e mendimit shkencor dhe të mësimdhënies në lëmin e gjeografisë. Për një kohë shoqata ishte shumë aktive, duke bashkuar mësimdhënës gjeografë, studentë dhe të tjerë të interesuar.

Shoqata ka botuar revistën shkencore “Kërkime gjeografike”, e cila deri më sot ka nxjerrë 17 numra. Ka organizuar edhe një numër konferencash shkencore, seminare për mësimdhënësit e gjeografisë dhe aktivitete të tjera. Përmes kësaj shoqate një numër i mësimdhënësve të departamentit të gjeografisë mbajtën ligjërata të ndryshme me tematikë gjeografike brenda dhe jashtë vendit. (Shpejtim Bulliqi)

SHOQATA E KOMPOZITORËVE E KOSOVËS. Asociacion i krijuesve muzikorë të Kosovës, i themeluar në vitin 1972, që shënonte ngritjen në shkallë më të zhvilluar të veprimtarisë muzikore në Kosovë dhe avancim në organizimin e mëvetësishëm të krijuesve të kësaj fushe. Në vitet vijuese kjo Shoqatë u bë asociacioni kryesor profesional i krijimtarisë muzikore artistike në Kosovë, duke u plotësuar me anëtarë të rinj: kompozitorë të muzikës serioze, të muzikës së lehtë, argëtuese dhe të asaj në frymën popullore, si dhe me etnomuzikologë, muzikologë, studiues, kritikë të muzikës etj. Anëtarët e Shoqatës gjatë viteve ‘70 i kontribuan edhe themelimit të Shoqatës së Artistëve Muzikorë, rithemelimit të Shoqatës së Pedagogëve Muzikorë dhe themelimit dhe mbajtjes së festivaleve “Skena Muzikore e Prishtinës” dhe “Ditët e Muzikës Kosovare”. Në këto festivale dhe në organizime të ndryshme, nga vitet ‘70 u realizuan një numër veprash të autorëve tanë gjinish të ndryshme, solistike e kamerale, orkestrale e koncertale, deri dhe ato muzikore-skenike. Shoqata u shtua dukshëm me anëtarë të rinj, për të arritur në mbi 40 në fund të viteve ‘80. Shoqata delegonte anëtarët e vet në juritë profesionale të festivaleve të ndryshme brenda e jashtë Kosovës. Në fillim të viteve ‘90, pas ndërhyrjes së Serbisë në shuarjen e institucioneve të Kosovës, pushuan edhe aktivitetet e shoqatave të krijuesve të artit, iu shkatërrua dokumentacioni, iu morën dhe iu dëmtuan lokalet etj. Pas vitit 1999 dhe pas pavarësisë së Kosovës, anëtarët e Shoqatës së Kompozitorëve ia arritën t’i rikthejnë lokalet, të rinisin organizimin e aktiviteteve, siç është organizimi i festivalit “Ditët e Muzikës Kosovare”, duke kontribuar në pasurimin e jetës muzikore dhe kulturore në Kosovë. (Zeqirja Ballata)

SHOQATA E MJEKËVE TË KOSOVËS (SHMK). U themelua në vitin 1970, si degë

e Shoqatës së Mjekëve të Serbisë. Formimi i shoqatës hasi në vështirësi, sepse u kundërshtua nga ana e mjekëve serbë. Pas vitit 1975, Shoqata e Mjekëve të Kosovës u bë e pavarur nga Serbia dhe u përfshi në asociacionin e shoqatave të mjekëve të ish-Jugosllavisë. Gjatë kësaj periudhe, kjo shoqatë dha kontribut në këmbimin e përvojave shkencore dhe profesionale me qendrat e tjera të ish-Jugosllavisë. Shoqata nxori revistën shkencore “Praxis Medica”, ku u publikuan shumë punime profesionale. Me rrënimin e autonomisë së Kosovës, u ndalua së funksionuari edhe SHMK-ja dhe u ndërpre botimi i revistës “Praxis Medica” në gjuhën shqipe. Në vitin 1990 u ndërmor iniciativa për rithemelimin e shoqatës së mjekëve të Kosovës, u mbajtën kuvendet rajonale dhe më 1992 u themelua Shoqata e Pavarur e Mjekëve të Kosovës. Po në këtë kohë rifilloi botimi i revistës “Praxis Medica”. SHMK-ja bëri një punë shumë të mirë në sensibilizimin e opinionit ndërkombëtar për situatën shëndetësore në Kosovë. (Binak Kastrati)

SHOQATA E PEDAGOGËVE MUZIKORË E KOSOVËS. Asociacion i mësimdhënësve muzikorë të niveleve të ndryshme të shkollimit në Kosovë. U themelua në vitet ‘50, ndërsa aktivitetin e mirëfilltë filloi ta zhvillonte në vitet ‘70, kur numri i mësimdhënësve dhe aktivistëve të tjerë të muzikës u shtua ndjeshëm. Në aktivitetet e shoqatës në ato vite u përfshinë kompozitorë dhe emra të tjerë të muzikës, të cilët njëkohësisht ushtronin punën mësimore-pedagogjike, veçmas pas hapjes së degës së muzikës në Akademinë e Arteve të Kosovës. Qëllimi i shoqatës ishte përmirësimi i teorisë dhe praktikës së pedagogjisë muzikore, duke organizuar, pos tjerash, takime profesionale, seminare e forma të tjera të aktivitetit muzikor dhe pedagogjik-profesional. Gjatë viteve ‘90, për shkak të rrethanave politike në Kosovë puna e shoqatës u ndërpre, por u riaktivizua sërish pas luftës (1999). Tani vazhdon iniciativa që shoqata të vazhdojë me modele të reja të punës, duke mbledhur dhe duke bashkëpunuar me të gjithë pedagogët muzikorë, për të këmbyer përvojat dhe ekspertizat me qëllim të përmirësimit të praktikës muzikore pedagogjike. (Zeqirja Ballata)

SHOQATA E VETERANËVE TË ARSIMIT. Organizatë vullnetare e veteranëve të arsimit

në Kosovë. Takimi i parë i veteranëve u mbajt në Prishtinë, më 27 shtator 1982, ku u zgjodh kryesia dhe kryesuesi Beqir Kastrati. Deri në vitin 1989 u mbajtën edhe shtatë takime të tjera: në Ferizaj-Kaçanik (1983), Prizren (1984), Gjakovë (1985), Gjilan (1986), Pejë (1987), Mitrovicë (1988), Prishtinë (1989). Në këto takime të veteranëve nga Kosova trajtoheshin tema të ndryshme nga fusha e arsimit, kryesisht tema që ishin me interes për këtë veprimtari dhe për Kosovën në tërësi; afirmohej dhe vlerësohej kontributi i veteranëve të arsimit etj. Në këto takime vjetore veteranët vizitonin edhe institucione dhe objekte të ndryshme arsimore, kulturore, ekonomike etj. Merrnin pjesë edhe të ftuar të veçantë nga fusha e arsimit, shkencës, politikës etj. (Hajrullah Koliqi)

SHOQATA HUMANITARE BAMIRËSE “NËNA TEREZË”. U themelua në vitin 1990 në Prishtinë. Në kuvendin themelues të shoqatës morën pjesë 123 anëtarë themelues. Kryetar i



NJË AKSION I SHOQATËS HUMANITARE “NËNA TEREZË”

kuvendit të shoqatës u zgjodh dom Lush Gjergji, ndërsa drejtor Jak Mita. Shoqata menjëherë filloi aktivitetin humanitar dhe për një kohë të shkurtër u themeluan degët e saj, brenda dhe jashtë Kosovës. Deri në vitin 1994 në Kosovë u themeluan 39 degë për territore komunale ose rajone të caktuara brenda një komune. Jashtë Kosovës, degë të shoqatës u themeluan në Kroaci (Zagreb, Sllavonski Brod, Osjek dhe Pulë), në Maqedoni (Shkup, Dibër, Ohër, Kërçovë, Kumanovë dhe Strugë), në Luginën e Preshevës (Preshevë dhe Bujanoc), në Mal të Zi (Plavë, Martinaj dhe Ulqin), në Gjermani (Berlin, Karlsruhe, Mannheim dhe Mynih), në Zvicër (Vaud-Lozanë, Gjenevë, Valais, Lucern, St.Galen, Zug, Turgau, Aarau, Kussnacht dhe

Hocdorf), në Suedi (Malme), në Danimarkë (Kopenhagen), në Francë (Paris), në Belgjikë (Bruksel), në Austri (Vjenë). Nëpër të gjitha këto degë në Kosovë u zhvillua veprimtaria humanitare-vullnetare, e cila kishte për qëllim zbutjen e gjendjes së rëndë sociale për mbijetesë të popullatës në Kosovë në kushtet e pushtetit të dhunshëm serb pas vitit 1990. Po ashtu Shoqata “Nëna Terezë” paralelisht ka vepruar edhe në mbrojtjen shëndetësore të popullatës. Për këtë qëllim në Kosovë kanë vepruar 104 ambulanca humanitare, të themeluara nga shoqata, që funksiononin nën përkujdesjen e degëve të shoqatës dhe të maternitetit në Prishtinë. (Pjetër Përgjoka)

SHOQËRIA KULTURORE ARTISTIKE “AGIMI”, PRIZREN. Shoqëri kulturore-artistike (SHKA) e Prizrenit, e cila për shumë kohë ishte bartëse kryesore e jetës kulturore



SHOQËRIA KULTURORE ARTISTIKE “AGIMI”, PRIZREN

në qytetin e Prizrenit. U themelua në nëntor të vitit 1944, në fillim e njohur si Kori i Komitetit Shqiptar, në krye të të cilit ishin intelektualët Zekeria Rexha dhe Anton Çetta, kryetari i parë i saj. Në fillim veproi grupi i këngëtarëve dhe aktorëve amatorë. Me këngëtarët punonte mësuesi Nuri Sherifi. Në vitin 1945 Ansambli u zgjerua dhe mori emrin Shoqëria kulturore-artistike “Agimi”. Në kuadër të saj u formua kori mikst, orkestrina popullore me këngëtarë, seksioni i folklorit dhe ai i dramës. Dirigjent i korit deri në vitin 1956 ishte Lorenc Antoni (1909-1991), i cili njëkohësisht kompozonte dhe këngë korale. Me korin “Agimi” u paraqit në Kosovë, në Beograd dhe në qendrat e tjera të ish-Jugosllavisë, duke afirmuar produksionin muzikor shqiptar dhe interpretimin. Me këtë

kor pastaj do të punojnë dhe muzicentët Vera Mjeda, Rexho Mulliqi, Engjëll Berisha, Mark Kaçinari, Xheladin Kastrati, Dashnor Xërxa etj. Në kuadër të SHKA "Agimi" lindi dhe orkestrina kamerale, e para e këtij formacioni në Kosovë, që përbëhej nga: Xhemil Doda, violinë, Nuri Sherifi, violinë, Lorenc Antoni, violonçel, Kolë B. Shiroka, flaut, Lazër Mjeda, klarinetë, Josip Barishiq, trumpet-bori, Nela Jakiq, piano (dy të fundit kroatë), Agustin Cin Mjeda, bass. Orkestrina në vitin 1950 do të bëhet bërthama e orkestrës së qytetit të Prizrenit. Programi i ansambleve përfshinte vepra klasike europiane, e më vonë edhe veprat e para orkestrale të Lorenc Antonit. (Reze Kryeziu-Breznica)

SHOQËRIA KULTURORE ARTISTIKE "HAJDAR DUSHI", GJAKOVË. Shoqëri kulturore e qytetit të Gjakovës, e themeluar në vitin 1960. Kryetar i parë i saj ishte Musa Efendia,



SHOQËRIA KULTURORE ARTISTIKE "HAJDAR DUSHI", GJAKOVË

drejtor artistik Ismet Peja, ndërsa udhëheqës artistik Zekria Çarkaxhiu. Orkestrina përbëhej nga: Zekria Çarkaxhiu (fizarmonikë, udhëheqës i orkestrës), Asllan Kryeziu (fizarmonikë), Isa Grezda (kitarë), Ramiz Malazogu (kitarë), Isa Ballata (bas-prim), Mazllom Mejzini (mandolinë), Rasim Cana (mandolinë), Bardhosh Rudi (kitarë e më vonë kontrabas), Ihson Pozhegu (mandolë) dhe Asllan Maxhupi (bateri). Shoqëria kishte dhe tri soliste femra: Fakete Kusari, Meliha Meqa-Kolqi dhe më vonë Naxha Kusari. Repertori i shoqërisë përbëhej nga këngët e vjetra gjakovare, shkodrane, këngët e Shqipërisë së Mesme etj. Karakteristikë e kësaj shoqërie muzikore ishte interpretimi i këngëve argëtuese (Naxha Kusari, Shyqri Nimani dhe Nazmi Bejtullahu), ndërsa këngëtarët popullorë ishin Ismet dhe Ismail Peja, Mazllom Mejzini, Ali La-

jci etj. SHKA "Hajdar Dushi" ka dhënë kontribut të çmueshëm në ruajtjen dhe kultivimin e melosit tonë popullor. (Krenar Doli)

SHOQËRIA KULTURORE-ARTISTIKE AKADEMIKE "RAMIZ SADIKU", PRISHTINË. U themelua në vitin 1962/63 dhe paraqiste një ngjarje të shënuar kulturore për kohën. Me punën dhe aktivitetin e saj ka kontribuar në zhvillimin e jetës kulturore jo vetëm të Prishtinës, por dhe më gjerë. Me seksionin e muzikës, të valleve, të dramës dhe korit e kanë përcjellë rrugëtimin artistik të Ansambllit mbi 7,000 anëtarë që kanë shfaqur programe të larmishme kulturore në vend dhe më gjerë. Reputacioni artistik i SHKAA "Ramiz Sadiku" pati përmasa kombëtare. Aty u zhvilluan shumë talente të njohura, që më pas ishin pjesë e orkestrave profesionale, grupeve amatore, pastaj regjisorë të mirënjohur shfaqjesh teatrale, deri tek emrat e dëshmuar të skenave kombëtare e ndërkombëtare. SHKAA "Ramiz Sadiku" ishte laureate e Çmimit të Dhjetorit, e çmimit të parë në Festivalin Ndërkombëtar në Efes të Izmirit (Turqi) dhe çmime të tjera prestigjioze në Itali, Qipro etj. Pjesëmarrje të rëndësishme pati edhe në Kroaci, Francë dhe Gjermani. Ansambli punoi në lokalet e veta deri më 1992, kur qe ashpërsuar fushata e deinstitutionalizimit kulturor dhe i të gjitha formave të jetës e punës në Kosovë. Ndonëse edhe më pas i vazhdoi aktivitetet e saj artistike, nuk i arriti më sukseset e mëparshme. (Sami Piraj)

SHOQËRIA MUZIKORE "YMER RIZA", GJAKOVË. Shoqëri muzikore e qytetit të Gjakovës, e themeluar më 1930 nga instrumentisti popullor Ymer Riza. Grupin e përbënin: Ymer Agë Riza (sharki), Din Bakija (sharki), Miftar Gjoka Çausi (sharki), Malush Ahmeti-Stublla (fizarmonikë e shtrirë ose e gjurit), Ymer Tullumi (bugari), Zija Bakija (ud), Nimon Dervishi (violinë), Haki Mejzini (dajre), Ahmet Kola (çampare). Këngëtarë ishin: Halim Sahatçija, Qamil Fazlija, Musa Peja, Hamëz Kaçi, Cakë Dana dhe më vonë Qamili i Vogël. Shoqëria ka dhënë kontribut të rëndësishëm gjatë gjysmës së parë të shek. XX, duke i ruajtur dhe bartur këngët nga një brez në brezin tjetër. Shquhej për mjeshtërinë e ekzekutimit të melodive të ndryshme karakteristike instrumentale, sidomos të karakterit vallëzues, si: "Vallja e sharkijave", "Vallja e Dah Polloshkës", "Vallja e detit", "Vallja

e çikave”, “Vallja e burrave”, “Vallja me jatagana”, “Vallja Bektashi” etj. Krahas valleve, ishin këngët e ndryshme karakteristike të ashikëve, apo këngë historike, për ngjarje dhe trima të njohur, si këngët për Skenderbeun, Mic Sokolin, Dah Polloshkën, Bajram Currin, Isa Boletinin, Hasan Prishtinën etj. (Krenar Doli)

SHOQËRITË AKSIONARE. Ligji në fuqi në Kosovë përkufizon një shoqëri aksionare si një preson juridik me personalitet të veçantë juridik, të ndarë dhe të dallueshëm nga pronarët e vet. Për dallim nga shoqëria me përgjegjësi të kufizuar, sipas legjislacionit të Kosovës shoqëria aksionare ka një strukturë më të përbërë qeverisëse, e cila përfshin, ndër të tjera, kryeshefin ekzekutiv, bordin e drejtorëve dhe kuvendin e aksionarëve. Kapitali themeltar për regjistrimin e një shoqërie aksionare në Kosovë është 10,000 euro. Edhe pse një shoqëri aksionare mund të ketë vetëm një pronar, kjo strukturë e organizimit ligjor të një korporate ka për qëllim të sigurojë një qeverisje efikase në një korporatë me shumë pronarë. (Dastid Pallaska)

SHOQËRITË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR. Sipas legjislacionit, në Kosovë shoqëria me përgjegjësi të kufizuar nënkupton një person juridik që ushtron aktivitet afarist me personalitet ligjor të ndarë dhe të veçantë nga pronarët e vet dhe që vetë ka zotësinë juridike për të vepruar, për të kontraktuar, për të mbajtur në pronësi pasuri, të padisë dhe për të qenë i paditur. Në Kosovë shoqëria me përgjegjësi të kufizuar është formë e organizimit që zakonisht hasen te korporatat që kanë më pak pronarë, pasi forma e organizimit të veprimtarisë dhe e qeverisjes është më e thjeshtë. Ligji në fuqi në Kosovë përcakton se në një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar pronari nuk është bashkëpronar dhe nuk ka interes pronësor mbi pasurinë e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar. Legjislacioni i Kosovës parasheh se interesat pronësore janë njësitë pronësore në një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe, si të tilla, mund, por nuk ka nevojë të evidentohen me certifikatat të pronësisë dhe mund të referohen si aksione. Në këto rrethana, shoqëria me përgjegjësi të kufizuar është përgjegjëse për detyrimet ndaj palëve të treta, me gjithë pasurinë e vet. Rrjedhimisht, pronarët nuk janë përgjegjës për detyrimet e shoqërisë me përgjegjësi të ku-

fizuar vetëm për arsye se janë pronarë. Ligji aktual në Kosovë parasheh se për themelimin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar nuk nevojitet kapitali themeltar. (Dastid Pallaska)

SHOSHOLLI Ajet (1945-). Trajner. Lindi në Mitrovicë. Nisi të merret me futboll që në fëmijëri. Ka luajtur te KF “Trepça” dhe KF “Remont” të Mitrovicës. Punën e trajnerit e filloi në vitin 1973 në KF “Kosova” të Vushtrrisë, kurse nga viti 1975 kalon në radhët e “Trepçës”. Në edicionin 1976/77 ishte ndihmëstrajner, kur “Trepça” bëhet anëtare e ligës së parë të ish-Jugosllavisë. Në vitin 1983 kalon në KF “Vëllaznimi” të Gjakovës, kurse një vit më pas emërohet trajner i KF “Prishtina”. Në vitin 1991, kur u shpërbë ish-Jugosllavia, klubi “Prishtina” nën drejtimin e A. Shoshollit ndërpret garat nën pushtimin Serbisë. Në edicionin e parë në futbollin e pavarur të Kosovës, “Prishtina” shpallet kampion (1991/92) dhe Shosholli emërohet përzgjedhës i përfaqësueses së Kosovës. Më 1994 emërohet trajner i skuadrës turke “Jeshil Urt”, që luan në ligën e katërt të Gjermanisë, kurse në vitin 1995 kalon te “Shkëndija” e Tetovës. Pas luftës në Kosovë (1999), në edicionin e parë me “Prishtinën” e fitoi titullin e kampionit, kurse rizgjidhet përzgjedhës i përfaqësueses së Kosovës. Në edicionin 2003/04 “Prishtina” nën drejtimin e tij bëhet përsëri kampione dhe fituese e superkupës së Kosovës. Në vitin 2010 u kthye te “Vëllaznimi”, kurse nga viti 2014 u emërua trajner i “Trepçës”. Është kryetar i Shoqatës së Trajnerëve të Futbollit të Kosovës. (Baki Berisha)

SHPELLA E AZEM GALICËS. Humnerë në pjesën veriore të fshatit Përçevë, në lartësi mbidetare 612 m, në largësi 1.5 km nga rruga magjistrale Prishtinë-Pejë. Deri më sot nuk është hulumtuar. Njihet me emrin Shpella e Azem Galicës, pasi në të kanë qenë të fshehura eshtrat e heroit Azem Galica. Hyrja në shpellë është mjaft e ngushtë dhe e vështirë. Shpella ka një kanal vertikal me thellësi 70 m, gjerësi 0.60-1.5 m. Në fund të kanalit vazhdon korridori horizontal i pasur me stalaktite dhe stalagmite. (Fadil Bajraktari)

SHPELLA E DUSHIT. Shpellë në veri të kantonit të Mirushës, afër fshatit Dush (Klinë), në lartësi mbidetare 516 m. Është krijuar në

shkëmbinjtë gëlqerorë me rudistë të kretakut, me veprimin e një rrjedhjeje ujore të përkohshme, e cila në hyrje të shpellës merr karakterin e një rrjedhje nëntokësore. Gjatësia e përgjithshme e kanaleve të huluntuara është rreth 500 m. Hyrja ndodhet në juglindje, me gjerësi 8.4 m dhe lartësi 12.6 m. Në korridorin kryesor të shpellës mund të depërtohet pa vështirësi deri në 120 m brendi, pa pajisje speleologjike. Korridori degëzohet në kanale më të vogla. Pengesa e parë që paraqitet është liqeni i parë, me gjatësi rreth 6 m dhe thellësi 2.5 m. Ekzistojnë edhe liqene të tjera me forma dhe dimensione të ndryshme. Është e pasur me stalaktite, stalagmite, kolona etj. Paraqitja e stalaktiteve dhe e stalagmiteve fillon pas liqenit të parë, ndërsa kolonat janë të pranishme që në hyrje të shpellës. Në shpellë jetojnë lakuriqët. Shpella bën pjesë në kuadër të zonës së mbrojtur të Ujëvarave të Mirushës. (Fadil Bajraktari)

SHPELLA E GADIMES. Shpellë karstike, njihet edhe me emrin Shpella e Mermertë. Ndodhet në fshatin Gadime e Ulët (Lipjan) në lartësi mbidetare 580 m, 3 km larg magjistrales



PAMJE E SHPELLËS SË GADIMES

Prishtinë-Ferizaj dhe afër 20 km në jug të Prishtinës. U zbulua nga fshatarët në vitin 1967. Hyrja e saj është në grykën e lumit të Gadimes. Është hapur për vizitorë në vitin 1976, ndërsa është shpallur monument natyror me rëndësi të veçantë në vitin 2009. Shpella

është krijuar nga veprimtaria tretëse e ujërave në një thjerrëz relativisht të vogël të mermerëve, të ndërftuar në shkëmbinj rreshporë të moshës permotriasike. Në aspektin kohor, shpella është më e hershme se faza liqenore e fushëgropës së Kosovës dhe gjatë kësaj kohe sedimentet e depozituara kanë mbuluar hyrjet e saj parësore. Konsiderohet se është zhvilluar në tri nivele. Është përgatitur për vizitorë në nivelin e mesëm, në një gjatësi prej 1.5 km, por në të ardhmen kjo mund të shkojë në gjatësi mbi 3 km. Niveli i poshtëm, i cili konsiderohet se ekziston dhe se është i përmblytur nga sedimentet e pliocen-kuaternarit, ndërsa niveli i sipërm ende është i pahulumtuar.

Shpella përbëhet nga korridore, galeri e salla të mbushura me stalaktite, stalagmite, shtylla e kolona dhe shumë stoli të tjera me bukuri të rrallë. Galeria kryesore karakterizohet me zgavrime të ndryshme. Galeria perëndimore ka një korridor kryesor dhe disa salla që lidhen me korridore më të vegjël dhe me galeri të tjera. Në hyrje ndodhet salla më e madhe, e cila është e mbushur plot me stalaktite, stalagmite e kolona mermeri. Në të ndodhen edhe dy liqene të vegjël. Të shumta janë zgavrimet dhe korridoret edhe në galerinë veriore, por karakteristike për të janë të ashtuquajturat salla dhe një liqen. Është e njohur me stalaktite, stalagmite, kolona e perla shumëngjyrëshe.

Bukuritë e rralla dhe paraqitja e kristaleve të aragoniteve (lloj kalciti) në shpellë dhe rritja e tyre në të gjitha drejtimet, duke shpërfillur plotësisht gravitetin, e bën të veçantë Shpellën e Gadimes. Në shpellë është evidencuar një numër i konsiderueshëm i liqeneve ujore të përmasave të ndryshme, të cilët shpeshherë shkapërderdhen ose thahen. Pasi sasia e ujërave që infiltrohet në zonën e karstit është e vogël, është menduar se uji në shpellë vjen nga lumi, por me ngjyrosje të ujit të lumit, është konstatuar se uji nuk vjen nga lumi, por nga akuiferi intergranular, i mbështetur në anën verilindore të shpellës. Shpella ka vlera shkencore dhe turistike. E vizitohet gjatë gjithë vitit një numër relativisht i madh i turistëve vendorë dhe të huaj, pastaj i qytetarëve, nxënësve dhe studentëve. (Ruzhdi Pllana)

SHPELLA E GRYKËS SË MADHE. Shpellë në kilometrin e tetë të Grykës së Rugovës, në anën e djathtë, rreth 90 m mbi shtratin e lumit Bistrica

e Pejës. Hyrja është në anën veriore dhe gjendet në lartësinë mbidetare 637 m. Hulumtimet kanë filluar në vitin 1992. Gjatësia e korridoreve dhe e galerive të hulumtuara është rreth 13,450 m. Është njëra ndër shpellat më të mëdha në Kosovë dhe në rajon. Është krijuar nga rrjedha ujore nëntokësore në shkëmbinjtë gëlqerorë të triasikut. Në brendësi të shpellës gjenden disa rrjedha ujore dhe liqene nëntokësore. Ka një sistem të ndërlikuar të korridoreve dhe galerive nëntokësore. Shpella përbëhet prej tri niveleve (kateve). Niveli i dytë dhe i tretë i shpellës është i pasur me stalaktite, stalagmite, kolona etj. Karakterizohet me vlera natyrore, shkencore, hidrike, biologjike, edukative-arsimore dhe turistike. (Fadil Bajraktari)

SHPELLA E ILINCËS. Shpellë në veriperëndim të Preshevës (10 km). Ndodhet në pjesën juglindore të Karadakut në lartësi mbidetare prej 720 m. Quhet edhe Shpella e Vrellës, sipas burimit që ndodhet menjëherë para hyrjes së shpellës. Përbëhet prej pjesës hyrëse, kanalit të majtë ose kryesor, i cili në fund degëzohet në tri kanale, si dhe kanalit të djathtë, i cili është më i shkurtër. Gjatësia e përgjithshme e të gjitha kanaleve të shpellës është 584 m. Hyrja e shpellës ndodhet në pjesën verilindore, e cila së bashku me paradhomen (korridorin) është e gjatë 45 m. Ajo është e lartë 10 m, kurse e gjerë 3.4 m. Sa i përket formave të ndryshme të stolive të shpellës, kanali i majtë kryesor është i varfër me këto zbulime, të cilat ndodhen në fazën fillestare të zhvillimit. Përqendrimi më i madh i stolive haset në zgjerimet e kanalit. Aty, në tavanin e ulët, paraqiten stalaktitet me gjatësi deri në 10 cm. Ndërmjet tavanit dhe dyshemesë hasen edhe shtyllat deri 20-30 cm. Sidomos janë atraktive stolitë e rralla të shpellave, meduzat dhe sharrat. Vlerat e Shpellës së Ilincës janë didaktike, turistike dhe ekonomike. (Arsim Ejupi)

SHPELLA E KISHNAREKËS. Shpellë në fushëgropën e Drenicës. Gjendet në pjesën perëndimore të fshatit Kishnarekë, në lartësi mbidetare 654 m. Hyrja kryesore e shpellës është nga jugperëndimi, e lartë 2 m, e gjerë 4 m dhe me një gjatësi rreth 13 m. Rajoni në të cilin ndodhet shpella përbëhet kryesisht nga formacionet gëlqerore dhe flishore të kretakut dhe formacionet diabaz-strallore e serpentine të moshës së jurasikut. Korridoret e shpellës

janë të shtrirë në dy kate. Në katin e epërm gjenden kanali kryesor hyrës, kanali sekondar dhe kanali i stalaktiteve, ndërsa kati i poshtëm përbëhet nga “kanali i kupës”, “salla e shpellës” dhe “kanali i liqenit”. Gjatësia e përgjithshme e kanaleve dhe galerive të hulumtuara në shpellë është 182 m. Pjesa më interesante dhe më e rëndësishme e shpellës është “salla e shpellës”, e cila është e gjatë 37 m dhe e gjerë 15 m. Është e pasur me stalaktite, stalagmite dhe kolona. Shpella ka vlera shkencore, gjeomorfologjike, edukative-arsimore dhe turistike. Është shpallur monument i natyrës (2006), me sipërfaqe prej 2 ha. Nuk është e përgatitur për vizitorë. (Fadil Bajraktari)

SHPELLA E PANORCIT. Shpellë 3 km në jug të fshatit Panorci (Malishevë), në shpatet veriore të malit Okovan (977 m), në lartësi mbidetare 581 m. E ka marrë emrin sipas lokalitetit ku ndodhet, por njihet edhe me emërtime të tjera, si Shpella nën Hijë dhe Shpella e Flladit. Është krijuar në gëlqerorët me rudistë të kretakut të sipërm, e predisponuar nga litologjia dhe tektonika, me veprimtarinë tretëse të një rrjedhjeje ujore nëntokësore, që fillon nga fshati Zatriq. Hyrja në shpellë është nga drejtimi i veriut, me dimensione 1 m gjerësi dhe 0.5 m lartësi. Gjatësia e përgjithshme e korridoreve dhe e galerive të hulumtuara është rreth 1,050 m. Është e pasur me stalaktite, stalagmite, kolona etj. Ka vlera shkencore, gjeomorfologjike, edukative-arsimore, biologjike, hidrike dhe turistike. Është shpallur monument i natyrës (2014), me sipërfaqe 279 ha. (Fadil Bajraktari)

SHPELLA E RADAVCIT. Shpellë afër fshatit Radavc, pranë burimit të Drinit të Bardhë, rreth 11 km në veri të Pejës, pranë rrugës magjistrale Pejë-Rozhajë. Hyrja në shpellë është horizontale, në lartësinë mbidetare 578 m, në rrëzat e Rusolisë (2,381 m). Lartësia relative mbi burimin e Drinit të Bardhë është rreth 40 m. Është e krijuar në shkëmbinjtë gëlqerorë të triasikut me veprimin e ujërave të burimeve nëntokësore. Shpella ka tri kate dhe katër galeri, secila ka hyrje më vete. Galeria e poshtme është e mbushur me ujë. Në hyrje të saj buron Drini i Bardhë. Galeritë komunikojnë mes tyre nëpërmjet zgavrave dhe korridoreve me madhësi të ndryshme. Komunikimi është vertikal dhe horizontal. Mikroformat e galerive të kësaj shpelle janë të

shumta. Në galeri ka liqene që lidhen mes tyre me sifone. Shquhet për prezencën e vaskave, që shpëllën e bëjnë të veçantë. Stalaktitet, stalagmitet, kolonat dhe perdet e ngurta janë forma mbizotëruese. Gjatësia e përgjithshme e kanaleve të hulumtuara është 1,420 m. Në ambientet e galerive të sipërme ka lakuriqë nate dhe insekte të ndryshme. Në ujë takohet gaforrja e shpellave. Në këtë shpellë janë gjetur pjesë të nofullës së ariut të shpellave dhe fragmente të enëve prej qeramike të përdorura nga njeriu. Për shkak të vlerave shkencore, hidrologjike, geomorfologjike, biologjike, arkeologjike, edukative-arsimore dhe turistike është shpallur monument natyre dhe është vënë në mbrojtje (1983) me sipërfaqe prej 90 ha. (Fadil Bajraktari)

SHPELLA E RADAVCIT. Vendbanim shpellor mbi fshatin Radavc, pranë anës së djathtë të burimit të Drinit të Bardhë, rrëzë bjeshkës së Rusolisë. Përbëhet nga hyrja e orientuar nga verilindja, korridori që shpie në ambient të përshtatshëm për banim dhe disa qindra metra ambientesh që ende nuk janë gjurmuar. Në të janë gjetur eshtra të shtazëve të paleolitit, nofulla e ariut shpellor (*ursus spelaulus*), si dhe fragmente të qeramikes të cilat dëshmojnë për jetesë kohë pas kohe gjatë bronzit të mesëm, antikitetit të vonë (shek. V-VI) dhe mesjetës së hershme (shek. IX-XI). (Haxhi Mehmetaj)

SHPENDI Mehmet (Sokol Shpendi) (1851-1915). Atdhetar, drejtues i kryengritjeve popullore për çlirim kombëtar. Lindi në fshatin Pecaj të Shalës (Dukagjin). Që në rini të hershme mori pjesë në çetat e malësorëve kundër forcave turke dhe malazeze. Në periudhën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit udhëhoqi shalianët për mbrojtjen e Plavës e Gucisë, të Hotit e të Grudës. Më 1890 themeloi formacionin e luftëtarëve "Djelmnia e Shalës", të cilën e udhëhoqi në kuvende dhe në luftë. Ishte përfaqësues i Shalës dhe drejtues popullor në kryengritjet e Malësisë së Madhe të viteve 1910, 1911, 1912. Udhëhoqi luftën në Qafën e Agrit (korrik, 1910) kundër forcave osmane të Shefqet Turgut Pashës. Bashkëpunoi me Ded Gjo Lulin në revoltën e Malësisë së Madhe dhe ngritjen e flamurit në Deçiq. Njihet si njëri nga nënshkruesit e memorandumit të Greçës (qershor, 1911). Më pas udhëhoqi forcat kryengritëse për çlirim e Shkupit (1912), ndërsa ditën e pavarësisë ngriti flamurin kombëtar në

"logun e kuvendit", në Abat të Shalës. Më 1915 drejtoi qëndresën popullore për mbrojtjen e Dukagjinit. U kap në pabesi nga malazezët dhe më 15 korrik 1915 u pushkatua në fshatin Plan të Dukagjinit, me ç'rast u masakruan disa krerë të Shalës dhe banorë të fshatit. (Endrit Musaj)

SHPËRNGULJA E SHQIPTARËVE NDËRMJET DY LUFTËRAVE BOTËRORE. Përveç të ashtuquajturës reformë agrare kolonizuese, qeveritë në Beograd u angazhuan edhe për shpërnguljen me dhunë të shqiptarëve nga Kosova dhe viset e tjera shqiptare në Jugosllavi. Për realizimin e kësaj platforme antishqiptare, pushteti serb ushtroi terror dhe gjenocid sistematik shtetëror, përfshirë dhe forma të tjera të dhunës, për t'i detyruar shqiptarët t'i braktisnin trojet e tyre. Synohej gjithashtu që përmes formave të ndryshme të presionit të asimiloheshin sa më shumë shqiptarë. Në shërbim të kësaj politike u vunë institucionet shkencore e kulturore dhe intelektualë serbë, duke hartuar projekte të hollësishme për mënyra dhe forma më të përshtatshme të spastrimit etnik të trevave shqiptare. Në këtë kuadër, në "Klubin kulturor serb" shquheshin sidomos Vasa Çubrilloviqi me projektin e tij të njohur "Shpërngulja e shqiptarëve" (1937), si dhe Ivo Andriqi me projektin për pushtimin e Shqipërisë (1939).

Shpërnguljet e shqiptarëve vazhduan gjatë gjithë periudhës ndërmjet dy luftërave botërore. Shqiptarët e shpërngulur kryesisht shkonin në dy drejtime kryesore: në Turqi dhe në Shqipëri. Projektet për spastrimin etnik të shqiptarëve çuan te marrëveshja ndërshtetërore ndërmjet Jugosllavisë dhe Turqisë. Kështu, më 11 korrik të vitit 1938, në Stamboll u nënshkrua Konventa jugosllavo-turke për shpërnguljen e shqiptarëve për në Turqi. Sipas saj, parashihej që gjatë viteve 1939-1944 të shpërnguleshin për në Turqi rreth 400,000 shqiptarë, të cilët do të vendoseshin në shkretëtirat e Anadollit. Mirëpo në gjysmën e dytë të vitit 1938 dhe në fillim të vitit 1939 ndryshoi situata politike në Europë. Si rrjedhojë, edhe Konventa e humbi aktualitetin për Turqinë, e cila nuk pranoi ta ratifikonte atë.

Qëndresa e pandërprerë dhe shumëformëshe e shqiptarëve në vitet 1918-1941 ndikoi për ta mbajtur lart moralin e popullit shqiptar të Kosovës, për ta përballuar situatën e rëndë, dhunën e terrorin. Ajo ishte faktori kryesor

që pengoi shkombëtarizimin e shqiptarëve të Kosovës. Nëpunësit dhe funksionarët për realizimin e shpërnguljeve shpërbleheshin nga ana e shtetit. Çështja e shpërnguljes ishte bërë detyrë parësore e çdo titullari.

Si rezultat i shtypjes së vazhdueshme, gjatë periudhës ndërmjet dy luftërave botërore, sipas studiuesve shqiptarë, nga trojet etnike shqiptare u shpërngulën mbi 250,000 shqiptarë, ndërkaq historiani anglez Noel Malcolm thekson se numri i shqiptarëve të shpërngulur nga Kosova në periudhën ndërmjet dy luftërave botërore ishte ndërmjet 90,000 dhe 150,000. Pjesa dërrmuese e tyre u vendosen në Turqi, kurse pjesa tjetër në Shqipëri dhe në vende të tjera. (Lush Culaj).

SHPËRNGULJA E SHQIPTARËVE NË TURQI (1951-1966). Shpërngulja më masive e shqiptarëve të Kosovës për në Turqi pas Luftës së Dytë Botërore. Shpërngulja ishte e organizuar nga pushteti serb, i udhëhequr nga Aleksandër Rankoviqi, në bashkëpunim me Turqinë. Marrëveshja e pushtetit jugosllav dhe atij turk nënkuptonte shpërnguljen e të gjithë shtetasve turq nga Kosova për në Turqi. Mirëpo, represioni i pushtetit të Rankoviqit ndaj popullatës shqiptare në Kosovë e detyruan një shumicë syresh të regjistroheshin si turq dhe pastaj të kërkonin vizat për shpërngulje. Pushteti serb kishte planifikuar edhe operacionin e ashtuquajtur “Fshesa”, i cili kishte hartuar plane të detajuara për shpërnguljen e popullatës shqiptare dhe atë sipas zonave të quajtura si “pyka”. “Pyka lindore” përfshinte shpërnguljen e popullatës shqiptare nga trevat e Vranjës, Bujanocit, Preshevës, Kumanovës, Gjilanit, Ferizajt, Kaçanikut dhe Shkupit me rrethinë, kurse “Pyka perëndimore” përfshinte shpërnguljen e popullatës shqiptare nga trevat e Pejës, Gjakovës, Prizrenit, Mitrovicës, Llapit, Vushtrrisë, Drenicës, Tetovës, Gostivarit, Dibërës, Manastirit dhe Prespës. Gjatë këtyre viteve nga trojet etnike të shqiptare në ish-Jugosllavi u shpërngulën për në Turqi mbi 200,000 shqiptarë. Në pronat e tyre u vendosën kolonët serbë, malazezë dhe maqedonas, përafërsisht 50,000-60,000 kolonizatorë. Shpërngulja masive e shqiptarëve për në Turqi pushoi më 1966, pas Plenumit të Brioneve. (Hakif Bajrami)

SHPËRNGULJA E SHQIPTARËVE NGA SANXHAKU I NISHIT. Spastrim etnik i popullsisë shqiptare nga sanxhaku i Nishit, pas



SHPËRNGULJA E SHQIPTARËVE NGA SANXHAKU I NISHIT (1878)

pushtimit nga Serbia të këtyre territoreve gjatë Krizës Lindore 1875-1878. Në fund të vitit 1877 dhe në fillim të vitit 1878 ushtria serbe pushtoi territorin e sanxhakut të Nishit. Në kohën e depërtimit të ushtrisë serbe, gati të gjithë shqiptaret u shpërngulën për në Kosovë, Maqedoni, Turqi dhe në vendet e tjera. Nga kazaja e Prokuplës, Leskovcit, Nishit, Vranjës, Kurshumlisë dhe Pirotit numri i shqiptarëve të shpërngulur ishte shumë i madh. Ata u shpërngulën nga trojet e tyre nën represionin e egër të ushtrisë serbe, duke lënë shtëpitë dhe çdo gjë tjetër, me fëmijë të ngarkuar, pa ushqime dhe pa veshmbathje. Një numër i madh i të shpërngulurve u ngrinë nga të ftohtit dhe vdiqën rrugës. Forcat ushtarake të Serbisë bënë spastrim etnik të përmasave të mëdha, duke bërë ekzekutime të shumta, keqtrajtime, gjymtime fizike, pa kursyer as fëmijët, gratë dhe pleqtë. Si rezultat i dhunës dhe gjenocidit të ushtrisë serbe, rreth 35,000 shqiptar u vranë dhe u masakruan. Rreth 700 vendbanime shqiptare u spastruan etnikisht në rrethin e Nishit, të Prokupjes, Leskocit, Vranjës dhe të Kurshumlisë. Shumica e muhaxhirëve u vendosën në vilajetin e Kosovës, në sanxhakun e Prishtinës, në kazanë e Vushtrrisë, të Gjilanit, të Mitrovicës dhe më pak në Rrafshin e Dukagjinit. Një numër i tyre u vendos në Shkup, në Kumanovë dhe në Kërçovë. Vendbanimet shqiptare u plaçkitën, u dogjën dhe u shkatërruan. Serbia, në krye me Mita Rakiqin, para se të mbahej Kongresi i Berlinit, kishte dërguar ekipe për t'i popullzuar ato territore me kolonistë serbë. (Luan Tetaj)

SHPORTA Haxhi Rrustem (1864-1937). Titullar i fesë islame. Lindi në Prizren. Mësimet e

para i mori në vendlindje, i vazhdoi më pas në Stamboll. Gjatë qëndrimit në Stamboll u njoh me aktivistë dhe patriotë të shquar të Lëvizjes Kombëtare. Pas diplomimit (1896) u emërua myderriz në Medresenë “Mehmed Pasha” dhe myfti i Prizrenit. Nga ish-mbretëria jugosllave u dënua me 20 vjet burg dhe konfiskim të pasurisë, për shkak se kishte organizuar demonstrata në Prizren kundër pushtetit serb. Burgun e vuajti në Prizren, Shkup, Nish dhe Zenicë, nga ku u lirua më 1935. Ka lënë 8 vepra në dorëshkrim, që i përkasin etikës, shkencave kuranore, dogmatikës etj. (Resul Rexhepi)

SHPRONËSIMI (EKSPROPRIJIMI). Veprimet e një organi ekzekutiv në nivelin lokal (komunë) apo qendror (qeveri) të ndërmarra me qëllim të marrjes së detyrueshme të një të drejte apo interesi të ligjshëm në një pronë të paluajtshme, që është në zotërim apo pronësi të një personi fizik, sipërmarrjeje apo autoriteti publik; ose vendosja e detyrueshme e ndonjë servituti apo ndonjë të drejte tjetër të shfrytëzimit në pronën e paluajtshme. Si parim, shpronësimi kryhet për realizimin e një qëllimi të ligjshëm publik, në kuadër të ushtrimit të kompetencave ligjore të organit ekzekutiv që kryen procedurën e shpronësimit. Sipas ligjeve në fuqi, në Kosovë në nivelin lokal, komuna mund të kryejë shpronësimin, ndër të tjera, edhe për të zbatuar planin urbanistik ose hapësinor, për të ndërtuar ndonjë godinë për një autoritet publik, për ndërtimin e infrastrukturës publike komunale apo për shfrytëzimin e pasurisë nëntokësore sipas një licence të vlefshme minerare. Në anën tjetër, ligjet në fuqi në Kosovë parashohin se Qeveria mund të kryejë shpronësimin për të gjitha pikat e lartpërmendura, ashtu siç zbatohen në nivelin qendror, si dhe për mbrojtjen e monumenteve të trashëgimisë kulturore dhe vendeve me rëndësi arkeologjike, historike ose shkencore. Është me rëndësi të theksohet se, sipas ligjeve të Kosovës, shpronësimi mund të urdhërohet nga qeveria edhe për interes të ligjshëm privat, në rastet kur pronari i të drejtave sipërfaqësore mbi pronën e paluajtshme nuk i jep qasje një personi juridik për të shfrytëzuar pasuritë nëntokësore sipas një licence të vlefshme minerare. Për dallim nga shpronësimi për interes të ligjshëm publik, ku shpenzimet e shpronësimit dhe kompensimin e pronës së shpronësuar i mbulon autoriteti publik që kryen procesin e shpronësimit, ligjet e

Kosovës parashohin se në rastet e shpronësimit për interes të ligjshëm privat, shpenzimet e shpronësimit dhe kompensimi i pronës së shpronësuar mbulohen nga kompania që ka kërkuar kryerjen e shpronësimit për ushtrimin e aktivitetit të licencuar minerar. (Dastid Pallaska)

SHQIPËRIA. Shtet në jugperëndim të Gadishullit Ballkanik. Kryeqytet është Tirana. Del në brigjet e detit Adriatik dhe Jon. Ndodhet ndërmjet koordinatave gjeografike 39°38’



TIRANA

dhe 42°39’ të gjerësisë gjeografike veriore dhe 19°16’ e 21°4’ të gjatësisë gjeografike lindore. Ka shtrirje veri-jug deri 340 km dhe lindje-perëndim deri 148 km. Sipërfaqja e saj është 28,748 km², në të cilën jetojnë 2,9 milionë banorë (2014). Shqipëria ndodhet në distancën më të shkurtër midis Gadishullit Apenin dhe atij Ballkanik (kanali i Otrantos është 72 km i gjerë). Territori i saj përshkohet nga disa lugina të tërthorta që, për nga madhësia, janë të vetmet në gjithë pjesën perëndimore të Gadishullit Ballkanik. Këto lugina, të përshtatshme për ndërtimin e rrugëve, lidhin bregdetin e saj me brendësinë e vendit dhe gjithë Ballkanin. Në pjesën më të madhe të Luginës së Matit dhe lumit me të njëjtin emër dhe të lumit Fan është ndërtuar magjistralla automobilistike Durrës-Kukës-Morinë, e cila vazhdon më tej në territorin e Kosovës. Për shkak të rëndësisë që ka kjo rrugë në fushën e integritetit komunikativ, ekonomik, kulturor e social brenda trungut gjeoetnik shqiptar, ajo me të drejtë e ka marrë emrin “Ruga e Kombit”.

Në aspektin e ndërtimit gjeotektonik Shqipëria i takon degës jugore të brezit të rrudhosur alpin

mesdhetar. Vargmalet e territorit të saj quhen Albanide, të cilat në veriperëndim vazhdojnë me Dinaridet, kurse në juglindje me Helenidet. Formacionet më të vjetra i përkasin paleozoikut. Ato gjenden në pjesët lindore të vendit dhe përfaqësohen nga rreshtet e ndryshme, gëlqerorët e mermerizuar, kuarcitet, gipset etj. Formacionet mesozoike përfaqësohen nga shkëmbinj magmatikë të llojeve të ndryshme dhe nga shkëmbinj të sedimentarë. Këto formacione hasen kryesisht në pjesën veriore dhe lindore të vendit. Depozitimet kenozoike përfaqësohen nga ato terrigjene, flishore e molasike dhe më pak karbonatike. Gjenden kryesisht në pjesën perëndimore. Po këto hasen edhe në gropat e brendshme dhe më pak në ngritjet malore me lartësi mesatare. Shqipëria është e pasur me minerale metalike, sikurse me hekur-nikel (në pjesën juglindore të vendit), krom (në pjesën qendrore e juglindore), bakër (në veri), me boksite, magnezite, kaolinë, naftë, gaz natyror, qymyrguri, bitum, kripë të gurit, fosforite, kuarcite etj. Relievi i Shqipërisë dallohet me disnivele dhe dukshëm hipsometrik. Ai ngrihet nga niveli i detit deri në 2,751 m te mali i Korabit, por nuk mungojnë edhe disa pjesë të territorit nën nivelin e detit. Lartësia mesatare e relievit është 708 m, ndërsa ka karakter të theksuar kodrinor-malor. Relievi i ulët (deri 200 m mbi nivelin e detit) përfshin 23.4% të territorit; relievi i mesëm (200 deri 1,000 m lartësi) përfshin 48.1%, ndërsa relievi i lartë (mbi 1,000 m lartësi) përfshinë 28.5% të territorit të vendit. Vija bregdetare e Shqipërisë është 472 km, ose 16.4 km për 1,000 km², e cila, në raport me sipërfaqen e territorit zë vendin e dytë në Gadishullin Ballkanik, menjëherë pas Greqisë.

Shqipëria bën pjesë në brezin e klimës mesdhetare, ndërsa prania e relievit të lartë malor kushtëzon praninë e klimës malore. Vlerat mesatare të rrezatimit diellor arrijnë deri në 129 k/cal/cm². Temperaturat në Shqipëri ulen nga jugperëndimi në verilindje. Mesataret vjetore sillen nga 17.5°C në jugperëndim (pjesa bregdetare), deri në 7.5°C në verilindje. Në brendësi të vendit dimri është i ftohtë dhe me reshje. Këtu temperatura mesatare e janarit lëkundet nga -3°C deri në 2°C. Janë të shpeshta edhe temperaturat nga -5°C deri në -10°C. Kësaj pjese i përket edhe minimumi absolut i temperaturave me -25.8°C në fushëgropën e Korçës. Në Shqipëri bien mesatarisht 1,430

mm reshje në vit. Vlerat mesatare të reshjeve ndryshojnë nga 600-700 mm në fushëgropën e Korçës deri në 2,500-2,700 mm në pjesën perëndimore të Alpeve Shqiptare. Shqipëria ka një rrjet të dendur të lumenjve (1.7 km për çdo kilometër katror të sipërfaqes), me gjatësi të përgjithshme rreth 50,000 km. Rrjeti i përgjithshëm hidrografik i Shqipërisë përbëhet nga 136 lumenj, 10 liqene me sipërfaqe të përgjithshme ujore mbi 1,100 km², si dhe nga 200 burime kryesore me prurje ujore mbi 200 l/sek. Lumenjtë më të rëndësishëm të vendit janë: Drini, Buna, Mati, Shkumbini, Semani dhe Vjosa. Liqenet janë me origjinë tektonike, karstike, glaciale dhe bregdetare. Liqenet më të mëdha janë: i Shkodrës, i Ohrit dhe i Prespës. Sipas regjistrimit të fundit të popullsisë të vitit 2011, Shqipëria kishte 2,831,741 banorë, ndërsa 10 vjet më parë (2001) ajo kishte 3,069,275 banorë. Zvogëlimi për 237,534 banorë është kryesisht rrjedhojë e emigrimit jashtë vendit, por edhe e rënies së normës së natalitetit. Shqipëria dallohet me një shkallë të lartë të homogjenitetit etniko-demografik. Në numrin e përgjithshëm të popullsisë, shqiptarët përbëjnë shumicën dërrmuese. Nga bashkësitë e tjera jetojnë disa pakica kombëtare dhe grupe etnike, sikurse ajo greke (0.87%), maqedonase (0.2%), rome, malaziase, vllahe etj. Përbërja e popullsisë sipas përkatësisë fetare përbën një veçori dalluese të shoqërisë dhe shtetit shqiptar. Sipas të dhënave të regjistrimit të vitit 2011, 57.3% e popullsisë i takojnë besimit islam, 10.11% besimit katolik, ndërsa 6.8% besimit ortodoks. Si ateistë janë deklaruar 2.52%, bektashinj 2.11% dhe evangjelistë 0.11%. Derisa 5% janë deklaruar si besimtarë të pacilësuar, 13.8% e popullsisë kanë preferuar të mos deklarohen për përkatësinë e tyre fetare. Rreth 54% e popullsisë jeton në zonat urbane, karshi 46% e popullsisë që jeton në zonat rurale.

Megjithëse ka bazë të volitshme gjeografike-natyrore, periudha e gjatë e dominimit të pushtetit diktatorial, ideologjia komuniste me qëndrim të shprehur armiqësor ndaj shteteve të tjera çuan deri te vetizolimi ekonomik e politik disa dekadash, që u reflektua me prapambetjen e theksuar ekonomike dhe varfërimin e skajshëm të popullsisë. Fryma e ndryshimeve të sistemit ideologjik, politik dhe komunist që shfaqet në vendet e bllokut lindor në fund të

viteve '80 të shekullit të kaluar e preku edhe Shqipërinë. Kështu, në fund të vitit 1990, në Shqipëri, pas demonstratave të rinisë studentore, u rrëzua pushteti komunist dhe u krijua sistemi shumëpartiak. Partia e parë demokratike formohet në dhjetor të vitit 1990. Izolimi i gjatë politik dhe ekonomik, nëpër të cilin kishte kaluar shteti shqiptar kushtëzuan një periudhë të gjatë dhe të vështirë të transicionit. Shqipëria deri më sot ka arritur me sukses të integrohet në organizmat e ndryshme rajonale, kontinentale dhe globale me karakter politik, ekonomik dhe ushtarak. Ajo tanimë është anëtare e NATO-s dhe shtet kandidat për anëtarësim në Bashkimin Europian.

Kolektivizimi i bujqësisë dhe i pronave gjatë periudhës komuniste i jepnin vulën kryesore ekonomisë së centralizuar të shtetit. Sot kulturat kryesore bujqësore që mbillen dhe kultivohen në Shqipëri janë: drithërat, panxharsheqeri, patatet, agrumet etj. Disa prej tyre sot shfrytëzohen si lëndë e parë për degët e industrisë përpunuese ushqimore. Deri në Luftën e Dytë Botërore, Shqipëria kishte një zhvillim industrial të prapambetur, me vetëm disa ndërmarrje, më tepër të karakterit artizanal. Gjatë periudhës së okupimit italian, Shqipëria shënon një zhvillim të prekshëm ekonomik. Zhvillohen kryesisht degët e industrisë nxjerrëse dhe të përpunimit të lëndëve të para minerale, të materialeve ndërtimore etj. Me vendosjen e regjimit komunist, industria vazhdon të zhvillohet brenda modelit të një ekonomie të centralizuar, të kontrolluar dhe të planifikuar nga shteti. Gjatë kësaj periudhe zuri fill zhvillimi i industrisë, sidomos industria e rëndë. Pas shembjes së sistemit diktatorial, industria e trashëguar e Shqipërisë nuk arriti të jetë konkurrenente në tregjet ndërkombëtare. Kjo situatë imponoi nevojën për fillimin e një sërë reformash të thella ekonomike, të cilat kishin për synim orientimin drejt ekonomisë së tregut dhe konkurrencës së lirë. Degët kryesore të industrisë sot janë industria përpunuese ushqimore, e tekstilit, e naftës, kimike, e metaleve, prodhimi i energjisë etj. Qendra kryesore ekonomike, kulturore, arsimore dhe administrative është Tirana. Qendrat e tjera rajonale janë: Shkodra, Durrësi, Vlora, Elbasani, Korça, Gjirokastra, Berati etj. (Hivzi Islami, Arsim Ejupi)

SHQIPJA E BULLGARISË. E folmja e kolonisë shqiptare në Bullgari. Faktet e para të

regjistruara për mërgimin e shqiptarëve në territoret e banuara me bullgarë janë nga koha e sundimit osman. Kolonia e parë shqiptare është kjo në fshatin Kopilovci, në veriperëndim të Bullgarisë. Në vitin 1640 ka pasur 1, 200 veta dhe 360 fëmijë me kombësi shqiptare, të cilët kanë ardhur nga Shqipëria dhe e kanë ruajtur gjuhën e tyre. Katundi më i famshëm është ai i Arbanasit. Sot ka mbetur vetëm një fshat me popullsi shqiptare në Bullgari, Mandrica. Studime shkencore mbi të kanë bërë B. Sokolova, Dh. Shuteriqi etj. Punimi më i hollësishëm për këtë dialekt shqiptar është ai i B. Sokolovës. Banorët e sotëm të fshatit përbëjnë brezin e fundit që e flasin këtë dialekt. Gjuha e përdorur prej tyre është shumë arkaike. E folmja shqipe e Mandricës paraqet interes të veçantë për dialektologjinë historike të gjuhës shqipe. Ajo ka ruajtur togun zanor *ua* si në mbarë toskërishten. Zanorja *ë* ruhet, por në situata paratheksore asimilohet në *u* (*kupucë, kushtu, sumurë* etj.). Zanorja *y* alternohet në *u, ju* dhe *jy*. Bashkëtingëlloret *th* dhe *dh* janë alternuar kryesisht në *d* dhe *z*, ndërsa janë ruajtur grupet e vjetra konsonantike *kl* dhe *gl*. Bashkëtingëlloret *ll* alternohet në *l*, ndërsa *f*-ja nistore disa herë në *h* (*hustan, hushë*). Ka neutralizim të bashkëtingëlloreve të zëshme në fund të fjalës. Në morfologji, e folmja shqipe e Mandricës ka ruajtur disa trajta të lashta: kallëzorja me mbaresën *-në*: *kalnë, djalnë*; pjesorja me mbaresën *-rë*: *punuarë, larë* ose me *-tur*: *këndojtur, shkrojtur*. Në të kryerën e thjeshtë kemi tingullin *-t-* para mbaresave: *punojti, shkrojtiti*, por edhe raste të aoristit sigmatik: *klesha (qeshë), rasha (rashë), jerça (erdha)*. E pakryera del me mbaresën *nja*: *punonja*. Te gjinia e emrave kalojnë në femërore emrat e vjetër asnjans (*balla, uja, mjalta, gjalpa*) si dhe disa emra që në mbarë shqipen janë mashkullorë (*diella, pleha, klumështa*). E folmja e Mandricës ka ndikim jo vetëm të bullgarishtes (që vërehet në leksik, fonetikë e gramatikë), por edhe të turqishtes e të greqishtes. (Anton Pançev)

SHQIPJA E NJËSUAR LETRARE. Variant i përpunuar dhe i kodifikuar i gjuhës së popullit shqiptar. Në gjuhësinë bashkëkohore përdoret me emërtimin shqipja standarde. Realizohet në domene formale të përdorimit. Rruga e zhvillimit të shqipes së njësuar letrare, tok me proceset e vënies së rregullave të drejtshkrimit

si pjesë e rëndësishme të saj, ka qenë e gjatë dhe komplekse. Ka pasur afro një shekull të veprimtarisë intensive për planifikimin gjuhësor të shqipes dhe për vendosjen e rregullave të drejtshkrimit të saj. Gjatë kësaj kohe janë marrë vendime të ndryshme. Paraprakisht ka pasur një traditë shkrimore që ka vënë bazat e shqipes së njësuar letrare. Zhvillimet në fushën e shkrimit të shqipes nisin me Formulën e Pagëzimit të Pal Engjëllit (1462), për të vazhduar me autorët e vjetër: Buzuku (1555), Matrënga (1592), Budi (1618-21), Bardhi (1635), Bogdani (1685) etj., të cilët krijuan një traditë shkrimore. Në shek. XVIII do të ketë intensivikim të shkrimeve mbi bazën e toskërishtes dhe të arbërishtes së Italisë. Do të ketë, ndërkohë, edhe manifestime të shkrimit të arbnishtes së Zarës dhe të arbëreshëve të Greqisë. Tri variante kryesore shkrimi janë realizuar në këtë kohë: gegnisht, toskërisht dhe arbërisht, ndërsa brenda varianteve ka pasur edhe tendenca koineizimi, ndër të cilët më të dukshmet janë ato të Bogdanit dhe të Nikollë Ketës. Në kohën e Rilindjes Kombëtare, botimet e ndryshme, sidomos gazetat, paraqesin synimet drejt krijimit të një gjuhe kombëtare për nevoja kulturore të popullit shqiptar. Autorë si Luigj Gurakuqi, Aleksandër Xhuvani dhe Faik Konica prijnë në këtë kuadër. “Ëvetari” i Naum Veqilharxhit (1844) si dhe krijimi i “Shoqërisë së të shtypurit shkronja shqip” janë momente të rëndësishme të shprehjes së identitetit kulturor shqiptar dhe të gjuhës si mekanizëm të këtij identiteti. Gaspër Jakova-Merturi, më 1902, është i pari autor i regjistruar, që ka shënuar traktatin e parë për drejtshkrimin e shqipes. Ai e trajtonte nevojën për një ortografi unike për të gjithë shqiptarët. Traktati i tij do të ndiqej nga artikuj e traktate të ndryshme që i kushtohen kësaj çështjeje, ndërsa shoqëritë e Stambollit si dhe “Agimi” e “Bashkimi” të Shkodrës do të jenë qendra për diskutimet e kësaj fushe. Kongresi i Manastirit (1908) dhe Komisija Letrare e Shkodrës (1916-18) janë ngjarjet më të rëndësishme të veprimtarisë së organizuar për njësimin e shqipes. Kongresi i Manastirit bënte njësimin e alfabetit, ndërsa Komisija Letrare e Shkodrës atë të drejtshkrimit. Vendimet e Komisijës Letrare të Shkodrës janë miratuar në Kongresin e Lushnjës më 1920, ndërsa Qeveria Shqiptare, më 1923, ka marrë vendim që ta shpallte gjuhë zyrtare variantin që për bazë

kishte elbërishten. Ky variant ka qenë zyrtar deri më 1945. Gjatë kësaj periudhe ka pasur përdorime të varianteve të ndryshme dhe përpjekje për të kaluar në një fazë më të lartë njësimi. Sa për ilustrim mund të përmendet ortografia e jezuitit italian Adon Aldegierit, i cili më 1927 kishte publikuar një vepër me 64 faqe, në të cilën propozon një drejtshkrim të afërt me atë të elbërishtes letrare, por me elemente të shtuara të shkodranishtes. Veprimtari dhe ndërmarrje më serioze për planifikimin e shqipes realizohen pas Luftës së Dytë Botërore. Në këtë kohë kishte fillimisht punë të degëzuar: në një anë në shtetin e pavarur të Shqipërisë dhe, në anën tjetër, në viset shqiptare në ish-Jugosllavi. Në këtë periudhë edhe Shqipëria, edhe ish-Jugosllavia ishin vende me sisteme totalitare. Deri më 1968 në Kosovë dhe ish-Jugosllavi është zhvilluar një politikë e planifikimit vetanak, por gjithnjë duke u kujdesur që të mos ketë thellim dallimesh.

Në Shqipëri puna rreth planifikimit gjuhësor merr hov menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore. Themelimi i institucioneve të specializuara për studime gjuhësore ka luajtur rol të rëndësishëm në këtë drejtim. Në këtë kuadër do të përmendim ortografitë e viteve 1948-51, 1956, 1967 dhe 1973, si dhe konferencat e rëndësishme të viteve 1952, 1953, 1954-5 në Tiranë. Në Kosovë ka pasur ortografi të viteve 1952, 1957 dhe 1964 dhe konferenca të rëndësishme më 1952, 1957, 1961-1963, dhe sidomos ajo e vitit 1968. Pjesëmarrësit e Konsultës Gjuhësore të Prishtinës e përkrahën mendimin që ortografia e 1967-ës të aprovohej dhe të zbatohet edhe në Kosovë dhe në vise të tjera shqiptare në ish-Jugosllavi, për të arritur të formohej gjuha e njësuar letrare shqipe, e cila do të shërbente për komunikim gjithëkombëtar. Konsulta Gjuhësore e Prishtinës konsiderohet ngjarje e rëndësishme kombëtare drejt rrugës së standardizimit të gjuhës shqipe. Ajo ishte diskutimi i parë ndër shqiptarët e ish-Jugosllavisë për çështje të planifikimit të gjuhës, që po mbahej vetëm nën përkujdesjen e institucioneve shkencore-kulturore, pa përzierje të organeve të pushtetit.

Kjo veprimtari përmbillet me Kongresin e Drejtshkrimit në Tiranë më 1972.

Më vonë ka pasur edhe kritika për punën e Kongresit të Drejtshkrimit, ndërsa u themelua

edhe Këshilli Ndërkademi për Gjuhë Shqipe, i cili vazhdon të elaborojë standardin e shqipes, si “autoritet shkencor për shqyrtimin e të gjitha çështjeve që lidhen me përdorimin dhe zhvillimin e shqipes standarde”. Megjithatë, kritikata dhe puna e mëtejshme për shqipen standarde është realizuar si shtysë e nevojës për hapje dhe zgjerim të bazës së standardit dhe nevojës për të kaluar në një rrafsh të ri njësuës. (Bardh Rugova)

SHQIPJA E UKRAINËS (E FOLMJA E SHQIPTARËVE TË UKRAINËS). Flitet në katër fshatra në jug të Ukrainës, që u themeluan në shek. XIX: Zhovtnevoe (më parë quhej Kara-



SHQIPTARË TË UKRAINËS

kurt) në rrethin e Bollgradit, qarku i Odesës; Georgievka (Tyshki), Devnenskoe (Taz) dhe Gammovka (Xhandran) në rrethin e Priazovjes, qarku i Zaporozhjes. Sipas Censurit (2001) në këto fshatra dhe në qytete fqinje jetonin 3,308 shqiptarë. E folmja i përket toskërishtes veriore, por, që nga shek. XVI e këtej zhvillohet në shkëputje nga areali shqipfolës. Ka ruajtur mjaft tipare arkaike në fonetikë: 1) grupet e vjetra *kl, gl, lk, lg: klumështë, gluyë, ulk*; 2) *l*-ja ndërzanore: *golë, milë*; 3) shqiptimi i *ë*-së së patheksuar fundore: *bukë*. Gjithashtu edhe në morfologji: 1) gjinia asnjë: *ujtë, mishtë*; 2) dëftorë të gjinisë asnjë: *ata, këta*; 3) rase vendore: *ni ulicët* ‘në rrugën’; 4) mbaresa të lashta foljore në të tashmen dhe të pakryerën e dëftores dhe të lidhore. Zhvillimi i brendshëm dhe ndikimi i gjuhëve sllave dhe turke ka rezultuar me inovacionet në fonetikë: 1) monofongizimi i diftongjeve të vjetra *ua, ye, ie: grua > gru, pyes > pys, miell > mill*; 2) *h > γ* në fshatrat e Priazovjes: *ha > γa*; 3) *th > t, dh > d* para mblylltoreve: *i bardë, artka*; 4) *dh > ll* në Priazovje:

udhë > ullë. Po ashtu në gramatikë: 1) pjesëza e së ardhmes *at (ot) / ad (od): ad lamë* ‘do të lajmë’; 2) modeli ‘*bëj + infinitivi rus*’ për adaptimin e foljeve të huazuara nga rusishtja: *bun zvanit* ‘telefonoj’; 3) paravendosja e përcaktorit: *a bukur shtëpi* ‘shtëpia e bukur’, *a nuses vrayam* ‘fustani i nuses’, etj. Të parin vështrim mbi të folmen paraqiti akademiku rus Nikolaj Derzhavin në vitin 1920. Gjatë shek. XX dhe XXI me të folmen dhe etnografinë e shqiptarëve të Ukrainës merreshin studiuesit nga Moska (J. Ivanova, N. Kotova), nga Minsku (L. Demko), nga Leningradi / Sankt-Petërburgu (A. Desnickaja, I. Voronina, L. Sharapova, M. Domosileckaja, A. Zhugra, A. Novik, L. Kaminskaja, D. Ermolin, A. Dugushina, M. Morozova) dhe nga Shqipëria (S. Islami). (Marija Morozova)

SHQIPJA NË KOSOVË. Shqipja në Kosovë është gjuhë zyrtare dhe gjuhë e pjesës më të madhe të popullsisë së Kosovës. Shqipja e Kosovës bën pjesë kryesisht në kuadrin e të folmeve verilindore të gegnishtes, ndonëse në Rugovë kemi të folme të gegnishtes veriperëndimore, kurse në pjesën më jugore të folmet e arealit të Kaçanikut shtrihen drejt të folmeve të gegnishtes së mesme. Në Kosovë ka dallime mes grupit të të folmeve të Rrafshit të Dukagjinit (Deçan-Gjakovë) dhe Fushës së Pejës e të folmeve të Drenicës, në një anë, dhe të folmeve të Rrafshit të Kosovës, të Moravës së Epër, të Karadakut, të Llapit e Gollakut, të Shalës, në anën tjetër. E folmja e muhaxhirëve të shpëngulur në shekullin XIX nga Toplica e Kosanica është shkrirë në të folmet e Rrafshit të Kosovës. Shqipja popullore ka qenë gjuhë e popullatës shumicë në Kosovë gjatë periudhës osmane dhe gjatë sundimit të ish-Jugosllavive. Në Kosovë kemi shkrime shqip qysh herët. Pjetër Budi veprim kryesisht në Kosovë, ka botuar në shekullin XVII. Budi përmend shkrime të mëhershme të Palit prej Hasi, të cilat qarkullonin dorëshkrim, e që ai i kishte integruar në poezitë e Doktrinës së Krishtenë. Më vonë njihen botime të Gjon Nikollë Kazazit, të Tahir Efendi Boshnjakut, të Ndue Bytyçit, të Shtjefën Gjeçovit etj. Shkolla në gjuhën shqipe dhe përpjekje për mësimin e shqipes ka pasur qysh në sh. XIX, pastaj në dekadën e dytë të sh. XX, por në periudhën e Mbretërisë Serbe-Kroate-Sllavene dhe të Jugosllavisë para Luftë së Dytë Botërore u pamundësua çdo lloj i

përdorimit publik të shqipes, sidomos në shkolla. Në periudhën 1941-1945 janë hapur shkolla në gjuhën shqipe në pjesët e Kosovës që ishin bashkuar me Shqipninë nën Itali e Gjermani. Në to përdorej gegnishtja e shkruar siç ishte projektuar nga Komisioni Letrar. Pas vitit 1945, në Krahinën e Kosovës dhe të Metohisë kanë nisur proceset e alfabetizimit të popullatës që është përcjellë edhe në mësimin e shqipes në shkolla fillore dhe pak shkolla të mesme. Ka vazhduar gjithnjë përdorimi i gegnishtes së përgjithësuar, ndërsa nga 1952 ka pasur dhe përpjekje për normimin dhe selitjen e organizuar (Mbledhjet e viteve 1952, 1957, 1963 dhe Konsulta Gjuhësore e vitit 1968). Këto procese janë rritur me rritjen e rritjes të shkollave fillore e të mesme, të botimeve dhe të komunikimit në radio, ndërsa në dimensione më të plota përdorimi i shqipes, nevojat për standardizimin e saj dhe kërkesat për status të saj në përdorimet publike dhe zyrtare janë shtuar pas vitit 1966, kur është zgjeruar mësimi i saj në nivel universitar dhe janë rritur të drejtat e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës dhe të shqiptarëve brenda saj. Pas kësaj periudhe është shtuar pjesëmarrja në përdorimet dhe planifikimet për përdorimet publike të shqipes, sado që ajo ka mbetur gjithnjë me statusin e gjuhës zyrtare krahas serbishtes si gjuhë zyrtare. Në vitet '70-'80 të shek. XX në Kosovë ka pasur kërkesa për rritjen e hapësirës së përdorimit të shqipes në të gjitha funksionet e gjuhës standarde, ka pasur zhvillime të gjera të përdorimit të saj në shkolla, në universitet, në botime, në gazeta, në radio e televizion, në jetën shoqërore dhe në administratë, përveç ushtrisë, megjithatë zyrtarisht ka mbetur brenda statusit të gjuhëve të kombësive, jo të kombeve. Pas vitit 1981 ka pasur trysni të vazhdueshme për reduktimin e atyre përdorimeve në kuadër të trysnive të përgjithshme mbi statusin e Kosovës dhe të shqiptarëve të orkestruara nga Serbia, ndërsa pas vitit 1991 përdorimi i shqipes bashkë me sistemin shkollor në gjuhën shqipe janë nxjerrë jashtë ligjit, ashtu siç janë përjashtuar të punësuarit shqiptarë dhe është vendosur sistemi i plotë i aparteidit. Ligjrisht, brenda sistemit aneksues të Serbisë kishte mbetur gjithnjë mundësia e përdorimit të shqipes në funksionet publike, por me status ndjeshëm të reduktuar dhe në praktikë krejtësisht e përjashtuar bashkë me përdoruesit e saj.

Mund të thuhet se deri në këtë periudhë janë hetuar procese të fuqishme të ndikimit të serbokroatishtes mbi shqipen në përdorimet publike, ashtu si dhe reagime më të theksuara në mbrojtje të saj. Përdorimi i shqipes në të gjitha funksionet publike, të shkollës, të botimeve, të administratës, etj. ka vijuar brenda sistemit "paralel" që ka funksionuar gjatë viteve '90 me botimet, gazetat, mësimin në të gjitha nivelet e shkollimit, administratën për aq sa ishte, etj. Pas Luftës Çlirimtare të viteve 1998-1999 në Kosovë shqipja është kthyer në të gjitha përdorimet e gjuhës standarde dhe zyrtare me zhvillime në faza të ndryshme, varësisht nga statusi. Deri më 2008 përdorimet zyrtare të shqipes janë ndërlidhur jo vetëm me përdorimin zyrtar të serbishtes, tanimë jo të dirijuar zyrtarisht nga Serbia, por sidomos me përdorimin zyrtar të anglishtes në periudhën e UNMIK-ut dhe të administrimit ndërkombëtar. Në administratën shtetërore, në ligje dhe vendimmarrje statusi i anglishtes ka qenë parësor dhe trysnia mbi përdorimet e shqipes ishte shumë e madhe. Kushtetuta e Republikës së Kosovës e vitit 2008 e ka vendosur shqipen në statusin e njëres prej dy gjuhëve zyrtare (bashkë me serbishten), por për shkak të vazhdimin të proceseve të "pavarësisë së mbikëqyruar" trysnia e anglishtes ka vijuar. Kjo ndërkohë është ndërlidhur dhe me proceset globalizuese, ku mbisundon anglishtja po ashtu.

Sot shqipen në Kosovë e flasin të gjithë shqiptarët, ashkalinjtë, egjiptasit, një pjesë e romëve, turqit. Vërehet se ndërkohë e flasin për një pjesë dhe në kontekste të caktuara edhe goranët, boshnjakët dhe një pjesë e serbëve të integruar në institucionet e Kosovës. Në qytete të Kosovës në kohën e Perandorisë Osmane, popullata shqiptare e ka folur edhe turqishten si element për shprehje të një statusi social. Në kohën e ish-Jugosllavisë, një pjesë e madhe e popullatës shqiptare, sidomos ajo e arsimuara, e ka folur edhe gjuhën serbokroate, përkatësisht maqedonase. Sot shqipja ka hyrë në përdorimet e saj globalizuese: komunikimet intensive në mediat elektronike, në botimet dhe në funksionet e tjera kanë krijuar kontekst të ri përdorimi global të shqipes. Neni 5.1. i Kushtetutës së Republikës së Kosovës thotë "gjuhë zyrtare në Republikën e Kosovës janë gjuha shqipe dhe gjuha serbe", kurse paragrafi

5.2. shton: “Gjuha turke, boshnjake dhe ajo rome kanë statusin e gjuhëve zyrtare në nivel komune ose do të jenë në përdorim zyrtar në cilindo nivel në pajtim me ligjin”. Ligji për përdorimin e gjuhëve nr. 02/L-37 i vitit 2006 në nenin 2.1 ka sanksionuar që “gjuha shqipe dhe gjuha serbe dhe alfabetet e tyre janë gjuhë zyrtare në Kosovë”. Në aspektin statistikor, shqipja flitet nga rreth 92% e popullatës. (Rexhep Ismajli)

SHQIPJA STANDARDE. Përkufizohet si formë e gjuhës që funksionon si normë e referencës, sepse bashkësia gjuhësore e ka pranuar atë si etalon korrektese. Në rastin e shqipes kjo ka ndodhur në Kongresin e Drejtshkrimit të vitit 1972, si moment kulmor i zhvillimeve komplekse shoqërore, kulturore e sociolinguistike të mëhershme. Bashkësia gjuhësore e ndarë me kufij të papërshkueshëm e kishte pranuar këtë projekt edhe përtej problematikave që mund të ndesheshin në hapësirën ku shpesh mungonin hallkat e komunikimit ekonomik, kulturor e tjetër pikërisht edhe për shkak të funksioneve të gjuhës standarde, të cilat, sipas teorikut P. Garvin janë: *bashkimi*, në këtë rast jo vetëm në domenin dialektor, po edhe në rrafshin e ndarjeve të tjera të imponuara nga rrethanat e jashtme; *ndarja* identifikuese nga shoqëritë fqinje dhe *prestigji* që i jep bashkësisë që e përdor atë. Të gjitha këto janë dimensione që situatën e shqipes standarde e bëjnë të qëndrueshme në rrafshin simbolik, edhe përtej problematikave që sjell funksionimi i saj në jetën e bashkësisë. Shpesh mendohet se gjuha standarde duhet të jetë realiteti themelor dhe i natyrshëm i gjuhës, por duhet thënë se në të vërtetë çdo proces gjithsesi i gjatë i ndërhyrjes si kodifikimi dhe normimi, çka shoqëron patjetër statusin e gjuhës standarde, pra edhe të shqipes standarde, është rezultat artificial i atij procesi. Dialektet që nuk kanë jetuar procese normalizimi artificial janë varietete në raport me të cilat përcaktohet gjuha standarde. Nuk bën të harrohet se dialektet kanë po ashtu normat e tyre të korrektesisë, por ato nuk janë bërë eksplicite. Në rastin e shqipes gjendja bëhet edhe më e ndërliqshme për faktin se në historinë e saj ka pasur varietete të kodifikuara në mënyrë eksplicite mbi bazë dialektore apo të realiteteve konkrete të rajoneve të caktuara – variante të shqipes letrare (gegnishtja letrare, toskërishtja letrare dhe arbërishtja). Në këtë situatë, rea-

lizimi i shqipes standarde ka ndeshur tri palë vështirësish: duhej të superonte vështirësinë e parë që krijohet nga përdorimi i varietetit artificial në raport me varietetin natyror; të superonte vështirësitë e varieteteve të kodifikuara më herët, e që tashmë kishin një histori dhe një përvojë përdorimi; të superonte ndarjet shtetërore/politike, të cilat i vështirësonin shumë kontaktet me varietetin natyror që ishte vënë në bazë të shqipes standarde. Në disa tradita, gjithsesi shumë të njohura, si hebraikja, latinia, arabja, apo rastet imperiale, gjuha e shkruar ka sjellë me vete një shkallë të lartë kodifikimi, sepse ka qenë e lidhur me religjione të mëdha apo me pushtete enorme. Për të qenë efikase, administrata duhej të kishte në dorë mjete të stabilizuara gjuhësore. Ka dhe faktorë të tjerë me rëndësi në jetën e gjuhës standarde. Në rastet si shqipja, kanë qenë vetëdija dhe projektimi i identitetit kombëtar që e kanë favorizuar në masë të madhe normimin e varietetit që u bë gjuha e përbashkët standarde. Elementi simbolik i kohezionit të grupit, në këtë rast të kombit përballë fuqive ndarëse të para si rrezik nga jashtë, ishte i një rëndësie vendimtare për vendimmarrjet më 1968 në Konsultën Gjuhësore në Prishtinë, më 1972 në Kongresin e Drejtshkrimit në Tiranë, por në njëfarë mënyre rudimentare qysh në Komisinë Letrare në Shkodër (1916-1918) apo edhe në Kongresin e Manastirit më 1908.

Gjuhën standarde e karakterizon norma dhe normimi, ndërsa ndërlihdja me identitetin kombëtar dhe me elemente të tjera simbolike që normën e bën simbol të kohezionit të bashkësisë, i jep asaj vlerën e të pakontestueshmes. Në të tilla rrethana dialektet dhe varietetet e tjera marginalizohen si forma të dyshimta dhe si shmangie nga norma. Por në pesë shekuj të kulturës shqiptare kanë jetuar varietete të gjuhës së shkruar me shkallë të ndryshme normimi duke shërbyer si bartëse të krijimitarisë së gjerë dhe të vlerave që po ashtu lidhen me identitetin dhe elementet e tjera simbolike. Ideologjia pas së cilës gjendja e natyrshme e një gjuhe është ajo e gjuhës së normuar i ka vonuar studimet e proceseve. Standardizimi varet në një shkallë të lartë nga proceset e planifikimit të gjuhës. Sipas matricës së propozuar nga Einar Haugen janë disa procese nëpër të cilat kalojnë standardizimet gjuhësore: përzgjedhja e korpusit bazë për standardizim, çka domethënë përzgjedhja e një varieteti real të folur

dhe të shkruar, në rastin e shqipes së sotme përzgjedhja e bazës së toskërishtes letrare pas Luftës së Dytë Botërore; por ka edhe modele të përshtatjes së një kompromisi midis një tufe të folmesh të afërta, siç është rasti i gjermanishtes standarde. Në shqipen kemi pasur po ashtu elemente kompromisi midis dy varianteve të mëparme në rrafshin tingullor, në rrafshin morfologjik dhe sidomos në leksik. Faza tjetër me rëndësi në këto procese është elaborimi i korpusit bazë, që është proces i gjatë dhe që mund të jetë i organizuar ose më pak. Dhe ndërmarrjet e tilla lidhen me njësimin e grafisë (Kongresi i Manastirit, Komisija Letrare e Shkodrës, ortografitë e viteve 1947, 1951, 1956, 1964, 1967 dhe 1974; me rrafshimin e variacioneve morfosintaksore; me begatimin e leksikut dhe përshtatjen e tij si mjet për fusha të caktuara; me hartimin e veprave që përmbajnë kodifikimin - gramatika, fjalorë dhe që e bëjnë të mundur përhapjen. Në shqipen, menjëherë pas Kongresit të Drejtshkrimit, Qeveria e Republikës Socialiste të Shqipërisë kishte autorizuar Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë në Tiranë të hartonte vepra të tilla, ndërsa mjediset e tjera kishin abstenuar në heshtje nga kjo mundësi, çka do të thotë se pas Konsultës Gjuhësore të Prishtinës dhe Kongresit të Drejtshkrimit normimi bëhej nga një qendër e vetme, prandaj variacionet rajonale të shqipes standarde nuk janë variacione të policentrizmit (si në gjermanishtet në Gjermani, Zvicër, Austri, apo frëngjishtet Francë, Kanada, Belgjikë e vende të tjera frankofone), por variacione normale sociolinguistike

Në zhvillimet e dekadave të fundit në hapësirat e realizimit të shqipes së folur publike – më pak të shkruar, pra edhe standarde, hetohen dhe procese koineizimi të varieteteve relativisht të profilizuara. Kjo do të thotë se po ndodhin dhe procese standardizimi spontan, por gjithnjë duke u mbështetur në disa parime tashmë të shpallura si bazë për normën. Kështu edhe kur kemi prodhim letrar në varietete (dialektore ose jo) ndodh procesi i njësimin të grafisë, i reduktimit të variacioneve morfosintaksore, i përgjithësimit sa më të gjerë të leksikut.

Gjuha standarde është domosdo e shkruar, element që duket i domosdoshëm për çdo lloj ndërhyrjeje. Kjo do të thotë po ashtu se në gjuhën e folur standardi del gjithsesi më i labërguar, pra edhe më i përshkruar nga varietetet në parim përtej standardit.

Shqipja e sotme standarde ndodhet në një fazë dinamizmi, që lidhet me hapësirat gjeografike dhe shoqërore e shtetërore të përdorimit, me shtresëzimet shoqërore, me përdorimet e mjeteve të komunikimit në masë dhe të internetit, me proceset e globalizimit dhe me synimet drejt integritimeve brendashqiptare dhe europiane. Ky kompleks faktorësh tashmë po hetohet me ndikimet e dukshme në përgjithësimin e një bërthame të normave, por edhe me shanset që po u jepen përdorimeve të ndryshme në konkurrencën drejt përgjithësimit si normë. (Rexhep Ismajli)

SHRAM Gotfrid (Gottfried Schramm) (1929-2017). Historian gjerman. Lindi në Hajdelberg, studioi në Gëtingen, Tybingen e Erlangen për gjermanistikë, histori dhe sllavistikë. U doktorua në Gëtingen gjithnjë me tematikë filologjiko-historike. Specializoi në Paris, ndërsa për habilitim pati një temë historike për mesjetën e vonë në Poloni. Në studimet e tij ishte përqendruar sidomos në historitë kishtare e kushtetuese. Rindërtimet historike dhe politike i bënte mbi bazë të shqyrtimit të ligjësive dhe zhvillimeve në gjuhë. Ishte njohës i dalluar i historisë ruse. Nga viti 1994 ai nisi të botonte studime për historinë shqiptare, ndër të cilat veçohet vepra: “Fillet e krishterimit shqiptar: konvertimi i hershëm i besëve dhe pasojat e tij të gjata”, përkthyer dhe botuar shqip më 2006. Në studimet e tij për prejardhjen e shqiptarëve mbronte tezën për prejardhjen e tyre nga besët trakas. Tezat e tij i mbështeste në analizat e materialeve onomastike, po edhe të natyrës kulturo-historike. Ka zgjuar interesim sidomos shqyrtimi i tij për krishterimin e hershëm të besëve, që, sipas tij, ishte bërë nën udhëheqjen e Niketë Dardanit, sipas modelit të krishterimit të gotëve nga Ulfila. Në këtë kuadër ka pasur dhe diskutime të gjera lidhur me hamendësimet për shkrimin e shqipes më herët. Në këtë frymë ai ka emetuar dhe teza për prejardhjen e rumunëve në jug të Ballkanit, ku do të kenë pasur kontaktet me shqiptarët e hershëm. Tezat e tij, si të Vajgandit dhe të Georgievit më herët, janë kundërshtuar në albanistikë, ashtu si në romanistikë. (Rexhep Ismajli)

SHTABI I PËRGJITHSHËM I USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS (SHP i UÇK-SË). Trupë drejtuese dhe komanduese e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), që udhëhoqi të

gjitha operacionet e saj, që nga fillimi e deri në mbarim të luftës. Deri në vitin 1997 u quajt Shtabi Qendror, më pas Shtab i Përgjithshëm i UÇK-së. Njësoj si vetë UÇK-ja, edhe Shtabi i Përgjithshëm ka kaluar nëpër faza të ndryshme të zhvillimit. Faza e parë ka zgjatur deri në shpërthimin e luftës në mars të vitit 1998, kur një pjesë e madhe e Shtabit Qendror gjendeshin jashtë atdheut, ndërsa brenda atdheut ishin njerëzit e operativës dhe të aksioneve. Në këtë fazë e gjithë veprimtaria zhvillohej në kushtet e një fshehtësie të thellë. Veprimet operative kryesisht ishin guerile, sipas taktikës “sulmo e tërhiq”. Kjo fazë ka zgjatur deri në mars të vitit 1998, kur edhe bie Adem Jashari me familjen e tij. Faza e dytë përfshin riorganizimin e strukturave udhëheqëse dhe operative të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Në këtë fazë SHP po shkonte drejt legalizimit të drejtuesve të saj. Hapi i parë u bë me publikimin e zëdhënësve të tij të autorizuar, Jakup Krasniqi, brenda vendit dhe Bardhyl Mahmuti, jashtë vendit. Në vijim, në muajin gusht të vitit 1998 u bënë publik emrat e Drejtorisë Politike të UÇK-së: Hashim Thaçi (shëf i Drejtorisë Politike), Jakup Krasniqi, Bardhyl Mahmuti, Sokol Bashota, Xhavit Haliti, Faton Mehmetaj dhe Ramë Buja, që të gjithë të caktuar si përfaqësues politikë me detyra të ndryshme. Ndërkaq, Adem Demaçi ishte autorizuar si përfaqësues i UÇK-së për bashkëpunim me spektrin politik gjithëkombëtar. Në të njëjtën kohë u bënë publik edhe emrat e grupit diplomatik të UÇK-së në vende të ndryshme të botës. Gjatë muajve korrik-gusht të vitit 1998, SHP i UÇK-së bëri përpjekjet e para për të strukturuar organet drejtuese në të gjitha nivelet. Në këtë kohë u themeluan formacionet e para deri në brigada. Gjatë kësaj periudhe u ndërморën luftime frontale në Drenicë, Dukagjin, në Zonën e Pashtrikut, të ZO të Shalës dhe në Zonën e Nerodimes. U formuan edhe zonat e lira të UÇK-së. Një segment shumë i rëndësishëm për SHP të UÇK-së ishte Fondi “Vendlindja thërret”. Kryetar i Fondit ishte Jashar Salihu, i emigruar në Zvicër. Faza e tretë filloi me mbledhjen e SHP të UÇK-së, të mbajtur më 12 nëntor 1998 në fshatin Lladrofc të Malishevës. Në këtë mbledhje u bë strukturimi dhe plotësimi i SHP të UÇK-së me anëtarë të rinj. Sipas strukturimit të ri, në SHP shumica e anëtarëve të Drejtorisë Politike do të merrnin edhe përgjegjësi ushtarake. Komandant i Përgjithshëm i UÇK-

së ishte Azem Syla, Hashim Thaçi drejtonte Drejtorinë Politike, zëvendëskomandant për operacione ishte Sokol Bashota, Jakup Krasniqi ishte zëvendëskomandant për mbështetje dhe zëdhënës, Rexhep Selimi ishte inspektor i përgjithshëm, shëf i Shtabit ishte Bislim Zyrap. Ndërsa kryeshefa të drejtorive ishin: Adem Grabovci (Drejtoria Personale), Kadri Veseli (Drejtoria e Shërbimit Informativ), Sali Veseli (Drejtoria Operative), Xhavit Haliti (Drejtoria e Logjistikës), Ramë Buja (Drejtoria e Marrëdhënëve Publike), Musë Jashari (Drejtoria e Komunkimit dhe Ndërlidhjes), Lahi Ibrahim (Drejtoria për Financa), Berat Luzha dhe Ahmet Qiriri (Drejtoria e Informimit Publik) dhe Fatmir Limaj (Drejtoria e Policisë Ushtarake). Në përbërjen e SHP-së ishin edhe komandantët e zonave operative (ZO). Ata ishin: Sylejman Selimi, më pas Sami Lushtaku (ZO e Drenicës), Musa Jashari, më pas Ekrem Rexha (ZO e Pashtrikut), Ramush Haradinaj (ZO e Dukagjinit), Rrustem Mustafa (ZO e Llapit), Rrahman Rama (ZO e Shalës), Shukri Buja (ZO e Nerodimes), Ahmet Jusufi (ZO e Karadakut). Në përbërje të SHP të UÇK-së kishte edhe anëtarë të tjerë, por ata nuk ishin pjesë e vendimmarrjes. Njëri nga ata ishte kryetari i Fondit “Vendlindja thërret”, Jashar Salihu. Nga SHP në këtë fazë e deri në çlirimin e vendit u morën vendime të rëndësishme politike dhe ushtarake për të ardhmen e Kosovës. (Jakup Krasniqi)

SHTATORJA E GRUAS DARDANE (SUHAREKË). Shtatore e periudhës romake. Paraqet shtatoren e parë të gruas së punuar në plastikë të plotë në Kosovë dhe të dytën në Dardani, pos asaj nga Nishi. Është punuar në mermer të bardhë dhe i mungon koka dhe pjesa e poshtme e shtatit (59 cm). Ka qëndrim frontal dhe mban të veshur petkun ilir, të përbërë nga këmisha me mëngë të gjata dhe fustan pa mëngë, me prerje gjysmërrethore te qafa dhe brez të gjerë te gjoksi. Fustani është kapur në supe me fibula të rrumbullakëta. Mbi kokë ka një lloj manteli, që mbulon supet e shpinën dhe në skajet e përparme bie në trajtë shiritash vertikale, duke e lënë gjoksin dhe pjesën nën brez të zbuluar. Kjo mënyrë e mbajtjes së mantelit ndeshet te pjesa më e madhe e bust-portreteve të stelave në Dardani, sidomos të atyre nga Peja. Mbajtje të ngjashme kanë dhe reliefet e grave në stelat e Bosnjës, sidomos ajo

e Zenicës. Nga mbetjet plastike jo të qarta në supe, supozohet se mbi kokë mbante shaminë. Rreth qafës ka qaforen masive me medaljon rrethor. Rëndësia e veçantë e shtatores qëndron në trajtimin tredimensional dhe në dokumentimin e veshjes së gruas dardane me komplete, duke e zbuluar gjatësinë e mantelit, i cili shkonte nën ije, ngjashëm me shtatoret e grave në stelat ilire më jugore (Shqipëri), e cila arrinte nyjat e këmbëve. Stili i punimit tregon se është punuar nga mjeshtër vendës rreth gjysmës së dytë të shek. II, apo fillim të shek. III. U gjet te “Kregza” pranë lumit Toplluha, gjatë nxjerrjes së gurëve në arat e një familjeje, rreth vitit 1930. (Exhlale Dobruna-Salihu)

SHTATORJA TOGATUS (MUSHTISHT). Shtatore mashkulli e periudhës romake. Është skulpturë e plotë e skalitur në mermer të bardhë, së cilës i mungon koka me një pjesë të madhe të qafës, pëllëmba e dorës së majtë dhe pjesa e këmbëve mbi nyell, ndërsa është dëmtuar edhe pëllëmba e dorës së djathtë (120 cm). Paraqet një person që qëndron në këmbë në pozicion kontraposto, me peshën e trupit të rënduar mbi këmbën e majtë, ndërsa e djathta është e përkulur lehtë në gu. Duart i ka të lakuara në bërryl, e djathta është e vendosur mbi brez në drejtim të kraharorit dhe shtrëngon disa pala të veshjes, kurse me të majtën të shtrirë duket se mbante një objket. Elementi më karakteristik është veshja e përbërë nga tunika (këmisha) dhe toga. Tunika me mëngë të shkurtra dhe prerje ovale rreth qafës duket vetëm në kraharorin e anës së djathtë dhe krahun e saj deri te bërryli. Toga që mbështjell trupin, ka kind të pjerrët përmes gjoksit, i cili te brezi masiv formon një hark të vogël (umbo) dhe kindi tjetër arrin deri në gjurin e majtë, duke formuar një hark (sinus). Prapa dhe anash është trajtuar mjaft thjesht, që tregon se është punuar për t'u shikuar vetëm nga pjesa e përparme. Është shtatore e vetme me togë e gjetur në Dardani dhe ndoshta paraqet një magistrat, duke pasur parasysh se shtatoret e tipit “togatus” paraqesin persona me rëndësi dhe vendoseshin në vende publike. Togatusi filloi të mbahej gjatë fundit të Republikës Romake dhe fillimit të Perandorisë, duke u paraqitur sidomos gjatë dinastisë Jul-Klaude dhe Flave, ndërsa te personat e zakonshëm deri në shek. IV. Mënyra e punimit të gjithëmbarshtëm të shtatores, jo shumë të suksesshme në paraqitjen

e draperisë, tregon se ka dalë nga dora e një skulptori jo aq të shkathët, që vepronte në një punëtori vendore. Shtatore të këtij tipi ka në gjithë Perandorinë, por në trevat fqinje, pos Dakisë, janë të rralla. Nga katër shtatore magistratësh, karakteristikë e të cilëve ishte “toga praetexta”, dy vijnë nga veriu i Mezisë së Epërme dhe dy nga Apolonia dhe Dyrrahu. Një shtatore perandorake është gjetur në Naronë (Kroaci). Shtatorja u gjet te potezi “Simjan” të fshatit Mushtisht, gjatë hapjes së kanalit të ujësjellësit, në thellësi prej rreth 1.50 m. Është punuar rreth gjysmës së dytë të shek. II dhe gjysmës së parë të shek. III dhe gjendet në Muzeun e Kosovës (Exhlale Dobruna-Salihu)

SHTAZËT ENDEMIKE. Kosova karakterizohet me shumëllojshmëri të madhe të shtazëve, duke përfshirë edhe një numër të konsiderueshëm të llojeve endemike. Zonat e rëndësishme të pasura me lloje shtazore janë Bjeshkët e Nemuna, malet e Sharrit, të Pashtrikut, të Koznikut etj. Në Kosovë nuk është studiuar sa duhet fauna, prandaj dhe nuk dihen saktësisht të gjitha llojet endemike. Prej shtazëve të egra, një numër i tyre janë endemike dhe karakteristike për Ballkanin, të pranishme vetëm në disa zona tejet të kufizuara të Kosovës, siç është rasti me llojin karakteristik të rrëqebullit (*Lynx lynx*). Në Kosovë rrëqebulli jeton në dy masivet malore më të mëdha: në Sharr dhe në Bjeshkët e Nemuna. (Fetah Halili)

SHTETI DARDAN. Shtet që u krijua në shekullin IV p.e.r., me territor kompakt dhe popullsi të njohur, institucion të mbretit me fron trashëgues, ushtri të organizuar dhe relacione diplomatike. U zgjerua me përvetësimin e territoreve të tribalëve, autariatëve, taulantëve dhe peonëve, duke zënë rrjedhën e Drinit të Bardhë, të Ibrit me Sanxhakun, rrjedhën e Moravës Jugore e rrethin e Nishit, e deri te Velesi në jug. Shteti u krijua pas fazës së zhvillimit paraurban me aristokracinë fisnore në krye (VI-IV), lindjes së zejeve dhe diferencimit shoqëror, si dhe krijimit të qendrave urbane. Formimi i qendrave urbane përkon me shek. IV p.e.r. dhe është rezultat i përparimit ekonomik, specifikimit të zejeve të llojllojshme dhe krijimit të qendrave të mëdha tregtare. Këto u zhvilluan nga qendrat paraurbane dhe u ngrahën pranë udhëkryqeve tregtare, apo jo larg xehereve. Autori antik grek Straboni

disa prej qyteteve i quan “qytete të vjetra”, ndërsa autori romak Livi përmend një qytet të vjetër të vitit 176 p.e.r. dhe të gjitha qytetet i quan me emrin e përgjithshëm “urbs”. Duket se në mesin e tyre dhe si qytete të rëndësishme ishin Naissos, Arribantion, Ulpianon dhe Scupi, të cilat i përmend Ptolemeu në shek. II. Pos zhvillimit të bujqësisë dhe të blegtorisë, në këtë periudhë u intensifikua veprimtaria në xehtari, në metalurgji, në përpunimin e metaleve të çmuara e prodhim artizanal dhe tregti. Prodhimet dardane u bënë të njohura në botën antike, si shpatat e tipit *mahaira*, rrathët prej ari dhe djathi dardan, bashkë me dhjamin e derri, hekurin dhe plumbin. Shkalla e jetës ekonomike përfshinte qarkullimin e monedhave, të cilat u përdorën nga shek. V p.e.r., por u intensifikuan nga shek. IV p.e.r. Gjatë ekzistimit të shtetit dardan qarkulluan monedhat e Damastionit, Tebës, Histrisë, Apollonisë së Thrakisë, Lekës së Madh, të Filipit III, Athinës, Dyrrahut, Apolonisë së Ilirisë, Peonisë, Pellagonisë dhe denarët e Republikës së Romës. Shoqërinë e shek. IV-I p.e.r. e përbënte aristokracia skllavopronare, në krye me mbretin. Në aristokraci përfshiheshin edhe priftërinjtë dhe shtresa e lartë ushtarake. Shtresën vijuese e përbënin zejtarët, tregtarët dhe xehtarët, pastaj renditej fshatarësia e lirë dhe shtresën më të ulët e përbënin skllëvërit, për të cilët burimet antike pohojnë se ishin në numër shumë të madh. Skllëvërit përbëheshin nga dulët, si kategori e veçantë të dardanët dhe robërit e luftës. Shtetin e drejtonte mbreti. Emrat e mbretërve të tjerë nuk dihen, por njihet mbreti Longar (shek. III p.e.r.), djali i tij mbreti Bato dhe mbreti Monun (shek. II-I). Froni mbretëror ishte trashëgues dhe mbreti barte të gjitha funksionet shtetërore. Rreth mbretit duket se ishte dhe shtresa e “miqve të mbretit”. Këta merrnin pjesë edhe në delegacionet që dërgonte mbreti jashtë shtetit, si ai i vitit 200 p.e.r., për të lidhur aleancë me romakët, apo ai i vitit 177 p.e.r., që u paraqit para senatit në Romë, si dhe delegacionet në kuadër të kontakteve me shtetin ilir, atë peon, me medët, me etolët, me thesalët e të tjerë. Komandën mbi ushtrinë e organizuar në fallanga (8,000 ushtarë) e kishte mbreti, i cili në të shumtën e rasteve edhe e udhëhiqte betejën. Kështu, mbreti dardan, Longari, ishte në krye të ushtrisë në betejën kundër Demetrit II të

Maqedonisë, si dhe kur u pushtua krahina e Orestidës.

Dardania u bë fuqia më e madhe politike dhe ushtarake në Ballkanin Qendror deri në nismë të shek. I p.e.r. Në vitin 279 p.e.r. ishte aq e fuqishme, sa që mbreti dardan i ofroi mbretit të Maqedonisë, Ptolome Keraunit, një ndihmë prej 20,000 ushtarësh, për luftë kundër invadimit gal. Në vitin 200 p.e.r. u lidh aleanca me romakët dhe Dardania u bë pjesë e koalicionit antimqedon, deri në krijimin e provincës romake të Maqedonisë (168 p.e.r.). E pakënaqur, Dardania u kthye kundër romakëve, deri në përfundimin e “Luftës Dardane” (75-73 p.e.r.), kur u gjet në pozitë gjysmë të varur juridike. Edhe në këtë pozitë, Dardania iu kundërvu dominimit romak gati një shekull dhe vetëm pas Luftës së Mezisë (28 p.e.r.) romakët ia bashkëngjitën Dardanië provincës romake të Mezisë dhe, më pas, Mezisë së Epërme.

Zhvillimi dhe fuqizimi i shtetit mundësoi dhe zhvillimin e botës shpirtërore, me krijimin edhe të mbretërisë qiellore dhe hyj antropomorfë. Në këtë kohë u zhvilluan më tej dhe dijet kozmologjike, siç dëshmon monumenti me labirint rrethor i qarkut të mbyllur, i cili i është kushtuar Hyjneshës Dardane (viti 211). (Edi Shukriu)

SHTËPIA BOTUESE “BUZUKU”. Është e para shtëpi botuese private në Kosovë, në periudhën postkomuniste, e themeluar në vitin 1990. Botoi mbi 400 tituj, letërsi (poezi, tregime, romane, kritikë letrare), studime (shkenca shoqërore, filologji), publicistikë etj., të autorëve të traditës dhe të atyre bashkëkohorë, me interes të veçantë të disidenca letrare. Konsiderohet nga botuesit më aktivë në periudhat e krizës së librit në Kosovë dhe është bartës i shumë iniciativave për promovimin dhe shpërndarjen e librit. Mori pjesë në panairë botërore dhe në të gjitha panairët, sallonet dhe ekspozitat e librit të organizuara në trojet shqiptare. Është nga themeluesit e Panairit të Librit në Prishtinë dhe Shoqatës së Botuesve të Kosovës. Ndërmori shumë aktivitete me qëllim të nxitjes së krijimtarisë letrare dhe të autorëve të rinj, themeloi konkursin për roman si dhe për dramë bashkëkohore. Në listën e autorëve të saj ndeshim emra nga të gjitha hapësirat shqiptare dhe nga diaspora, por ka dhe emra të njohur të letërsisë botërore,

nobelistë dhe autorë të shquar të avangardës. Shtëpia Botuese “Buzuku” drejtohet nga Hana Zeneli, presidente, dhe Abdullah Zeneli, editor. (Eqrem Basha)

SHTËPIA BOTUESE “DITURIA ISLAME” (1993). Është institucion zyrtar i Bashkësisë Islame të Kosovës, e cila merret ekskluzivisht me botimin e literaturës fetare islame. Përveç kësaj, kjo shtëpi boton edhe vepra e monografi nga kultura, historia, tradita dhe trashëgimia jonë kulturore. Është themeluar në Prishtinë nga Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, më 1993, ndonëse veprimtaria botuese e Bashkësisë Islame zë fill më herët, që në vitet ‘70 të shekullit të kaluar. Në kuadër të Shtëpisë Botuese “Ditura islame” veprojnë biblioteka të veçanta botuese. Deri më tani Shtëpia Botuese “Ditura islame” ka nxjerrë në qarkullim mbi 400 tituj librash nga fusha të ndryshme fetare, si nga jurisprudenca islame, historia dhe qytetërimi islam, Tefsiri, Hadithi etj. Po ashtu janë botuar edhe një sërë monografish e botimesh të veçanta me vlerë për historiografinë, kulturën, gjuhësinë dhe letërsinë shqipe. Për vite të tëra Shtëpinë Botuese “Ditura islame” e ka udhëhequr Qemajl Morina, ndërsa tani ajo drejtohet nga Ahmet Sadriu. (Ramadan Shkodra)

SHTËPIA BOTUESE “DITURIA”. Një nga iniciativat e para të veprimtarisë botuese jashtë Shtëpisë Botuese “Rilindja”, e vetmja në Kosovën e fillimit të viteve ‘70, e nxitur nga gazeta e studentëve “Bota e re”, në kohën kur redaktor i saj ishte Ibrahim Rugova. Fillimisht, në vitin 1971, dolën librat me poezi “Hija e tokës” e Ali Podrimjes, “Opuset e maestros” e Eqrem Bashës dhe përkthimi i poezisë së poetit frëng Zhak Prever nga Rexhep Ismajli, me titull “Shi dhe kohë e bukur”. Seria mori titullin “Ditura”, si veprimtari e veçantë e gazetës së studentëve të Universitetit të Prishtinës, sipas titullit të revistës shkencore të studentëve “Ditura”, e drejtuar nga kryeredaktori Hivzi Islami, që asokohe çmohej edhe nga qarqet e tjera shkencore të Kosovës dhe konsiderohej si një frymë e re në qasjet bashkëkohore ndaj shkencës dhe dijeve. (Eqrem Basha)

SHTËPIA BOTUESE “DRITA”. Shtëpia Botuese e Ipeshkvisë së Kosovës. U themelua nga imzot Nikë Prela dhe veproi që nga viti 1980 e këndeje.

Fillimisht selia e shtëpisë botuese ishte në Ferizaj, gjatë viteve ‘90 u transferua në Prizren, ku atë kohë ishte edhe selia e ipeshkvisë, ndërkaq tani selia e saj është në Prishtinë, në rezidencën ipeshkvnore. Shtëpia Botuese “Drita” është themeluar pas një veprimtarie të gjerë fetare e kulturore të revistës “Drita” dhe për qëllim kishte botimin e literaturës së krishterë. Shtëpia botuese “Drita” ka botuar më shumë se 100 tituj të ndryshëm të fushave të ndryshme, biblike, liturgjike, katekistike, historike, përshtetjetje, monografike, shkencore, letrare, gjuhësore, muzikore etj. Ka botuar gjithashtu edhe vepra të rëndësishme për historiografinë shqiptare, kulturën dhe letërsinë. Një nga kontributet e rëndësishme të Shtëpisë Botuese “Drita” mbetet botimi i biblës, në përkthimin integral të dom Simon Filipajt, më 1994. Për shumë vjet veprimtarinë e kësaj shtëpie botuese e udhëhoqi dom Lush Gjergji, ndërkaq tani drejtor i saj është dom Fatmir Koliqi. (Ndue Ukaj)

SHTËPIA BOTUESE “DUKAGJINI”. Shtëpia botuese e themeluar në vitin 1994, nga një grup krijuesish dhe me mbështetjen e Ndërmarrjes Grafike Botuese Librare “Dukagjini” nga Peja. Për një kohë të shkurtër u afirmua si njëri ndër botuesit më të mëdhenj në Kosovë. I orientuar fillimisht te dijet humane (biblioteka “Fryma”) dhe letërsia bashkëkohore (biblioteka “Roza”), pas lufte inicoi kolanën “Dukagjini Balkan Books” në frëngjisht, anglisht dhe gjermanisht, me tituj nga historia, tradita dhe kultura shqiptare (“Kanuni”, “Historia e Shqipërisë”, “Spastrimet etnike”, autorë të traditës etj.). “Botimet e veçanta” sollën vepra të zgjedhura si dhe komplete veprash të autorëve tanë (F. Agani, G. Bobi), kurse nga viti 2004 u përqendrua në tekste shkollore, duke tubuar rreth vetes autorët më të njohur dhe duke u bërë sot lider i botimeve për arsimin fillor dhe të mesëm, mbështetur në plan-programet e Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë, të përshtatura moshave që u dedikohen. Janë mbi 200 tituj të realizuar në seritë e përmendura dhe rreth 170 tekste shkollore nga klasa I-XIII në gjuhën shqipe, në gjuhët e minoriteteve si dhe një sërë doracakësh për mësim në diasporë. Botimet e “Dukagjinit” u paraqitën në panairë dhe manifestime të tjera të librit në Prishtinë, Tiranë, Shkup, Frankfurt, Gjenevë etj. Në mbështetje të aktiviteteve të saj u hap dhe libraria

ndërkombëtare në Prishtinë, e para e këtij lloji në Kosovën e pasluftës. (Nazmi Rrahmani)

SHTËPIA BOTUESE “FAIK KONICA”. U themelua në fund të vitit 1999, me synim që të merret, në radhë të parë, me botimin e krijimtarisë origjinale të autorëve shqiptarë dhe të veprave të traditës letrare, gjuhësore, kulturore, shkencore e historike. Synim kryesor ka botimin e krijimtarisë së autorëve bashkëkohorë shqiptarë, botimin e veprave të plota të autorëve bashkëkohorë që kanë rumbullakuar ose përfunduar veprimtarinë e tyre, si dhe botimin e veprave të plota të autorëve të traditës, të botuara më herët ose të pabotuara. Deri tash ka botuar veprat e plota (komplete veprash) të Naim Frashërit (5 vëllime), Gjergj Fishtës (4 vëllime), Zef Skiroit (4 vëllime), Ethem Haxhiademit (2 vëllime), Musine Kokalarit, Anton Harapit (5 vëllime), Ernest Koliqit (6 vëllime), Faik Konicës (3 vëllime). Nga autorët bashkëkohorë ka botuar veprat e plota të Ibrahim Rugovës (9 vëllime), të Sabri Hamitit (10 vëllime), të Rrahman Dedajt (4 vëllime), të Rexhep Zogajt (10 vëllime), të Jusuf Gërvallës (4 vëllime), të Jusuf Buxhovit etj. Gjatë kësaj periudhe (1999-2015) kjo shtëpi botuese nxori mbi 600 tituj veprash të ndryshme, kryesisht letrare, të autorëve shqiptarë. Me botimet e veta merr pjesë nëpër panairët e librit në Prishtinë e Tiranë, Ulqin dhe vende të tjera shqiptare. (Eqrem Basha)

SHTËPIA BOTUESE “FJALA HYJNORE”. Shtëpi botuese e krishterë dhe revistë për kulturë religjioze. Boton literaturë të krishterë, por edhe vepra nga letërsia, përshpirtja dhe historia. Në kuadër të saj vepron edhe revista me të njëjtin emër e meshtarëve të Kosovës dhe e Institutit të Filozofisë dhe të Teologjisë në Shkodër. U themelua në vitin 2004 dhe që nga atëherë del rregullisht, një herë në tre muaj, duke u bërë një tribunë e mendimit kulturor të krishterë. Revista ka dy seli, në Prishtinë dhe në Shkodër. Revista boton tekste të kulturës religjioze të krishterë, të autorëve shqiptarë dhe të huaj. Vazhdon të luajë rol të rëndësishëm në promovimin literaturës religjioze, asaj kulturore dhe filozofike. Revista dhe shtëpia botuese bashkëpunojnë me intelektualë të shquar shqiptarë nga të gjitha hapësirat shqiptare. Kryeredaktor i revistës është dom Pren Kola. (Ndue Ukaj)

SHTËPIA BOTUESE “KOHA”. Shtëpi botuese e themeluar në kuadër të Grupit “Koha”. Ka nisur veprimtarinë më 1998 me “Kosova: një histori e shkurtër” të Noel Malcolmit. Pas vitit 1999 zgjeroi aktivitetin me botimin në vitin 2005 të 20 romaneve në kolanën “Shekulli XX”. Libri i parë i kësaj kolane “Emri i trëndafilut”, i U. Ekos iu fal lexuesve në 35 mijë ekzemplarë, ndërsa “Mjeshtri dhe Margarita” i M. Bulgakovit është libri më i shitur (15 mijë kopje). Kolanat e tjera të “Botimet Koha” janë: “Elephants” (publicistikë e vendit dhe e huaj); “Epoka” (publicistikë e lidhur për ngjarjet historike të Kosovës); “Koha ditore” (shkrimtarët e shekullit XX); “Junior” (libra për fëmijë); “Oda” (romanet në gjuhën shqipe); “Liburnia” (romanet e huaja të përkthyer); “Ars” (vepra për artin dhe kulturën); “Urb” (publicistikë e profilizuar); “Traduki” (romane nga serbokroatishtja përkrahur nga programi me po të njëjtin emër); “Poetica” (poezi); “Koha” (beletristikë) si dhe botimet e veçanta. Ka botuar mbi 145 tituj me rreth 370 mijë ekzemplarë. Rreth 2/3 e librave të botuar janë të autorëve shqiptarë. Janë botuar gjithsej 122 autorë (dhe bashkautorë). Merr pjesë rregullisht në panairët e librave në Prishtinë, Frankfurt, Tiranë dhe në panairët rajonale. (Eqrem Basha)

SHTËPIA BOTUESE “RILINDJA”. Redaksi e botimeve e Ndërmarrjes Gazetare Botuese dhe Grafike “Rilindja”. Ishte botuesi më i madh shqiptar në Kosovë në periudhën pas Luftës



NJË PANAIR I LIBRIT NË PRISHTINË

së Dytë Botërore dhe nga më të mëdhenjtë në rajon. Trashëgoi Shtëpinë Botuese “Mustafa Bakija” të themeluar në vitin 1950. Në këtë kohë veprimtaria botuese zhvillohej kryesisht

në botimin e librave shkollorë dhe veprave të përkthyer. Veprat e para origjinale të botuara janë “Gjethet e reja” e Rexhep Hoxhës, “Përrallat e Gjyshit” e Mark Krasniqit, “Kanga e vërrinit” e Martin Camajt etj. Në vitin 1956 kjo shtëpi botuese u integrua me shtypshkronjën “Milladin Popoviq” dhe për dy vjet vazhdoi veprimtarinë me këtë emër. Si ndërmarrje botuese dhe grafike “Rilindja” u themelua në vitin 1958, me bashkimin e redaksisë së botimeve, të shtypshkronjës me gazetën “Rilindja”, për të vazhduar edhe më tepër me botimin e veprave origjinale dhe të përkthyer dhe për t’u bërë e vetmja dhe më e madhja shtëpi botuese në Kosovë në ato kohë. “Rilindja” ka botuar mbi 2,000 vepra të autorëve shqiptarë. Numri i përgjithshëm i botimeve të saj, deri në vënien e masave të dhunshme në vitin 1989 dhe mbylljen e saj nga autoritetet represive serbe në vitin 1990, ishte mbi 3,800 tituj, me një tirazh rreth 24 milionë ekzemplarë. Pothuaj të gjithë autorët, shkrimtarët, publicistët, studiuesit, përkthyesit letrarë nga Kosova, por edhe nga Maqedonia dhe viset shqiptare të ish-Jugosllavisë për një kohë të gjatë e kishin “Rilindjen” adresën e vetme për realizimin e projekteve të tyre botuese. Përmes “Rilindjes” lexuesi shqiptar i Kosovës njëkohësisht u njoh dhe me emrat më të rëndësishëm të letërsisë shqiptare që krijohej në Shqipëri, por edhe tek arbëreshët e Italisë, të Zarës dhe të shqiptarët e diasporës. Rilindja nxiste dhe stimulonte veprimtarinë krijuese, publicistike dhe shkencore të shkrimtarëve, gjuhëtarëve, historianëve, publicistëve, si dhe të përkthyesve, duke sjellë në shqip vepra të rëndësishme të letërsisë botërore dhe të popujve të ish-Jugosllavisë. Ajo kishte seri të veçanta për fëmijë dhe botonte autorë të zgjedhur nga Kosova dhe Shqipëria, por edhe autorë botërorë, si dhe lekturën për nxënës të të gjitha niveleve të përshtatur me planprogramet mësimore. Veçohet botimi i autorëve të traditës, veprat e zgjedhura apo të plota të Naim Frashërit, Çajupit, De Radës, Migjenit, Asdrenit, Sami Frashërit, Nolit, Mjedjes, Gjeçovit, Gurakuqit, Fishtës, Poradecit etj., por edhe të autorëve bashkëkohorë, shkrimtarë e studiues, siç ishin veprat e plota të Ismail Kadaresë, apo të gjuhëtarit Eqrem Çabej, pastaj vepra të plota të autorëve nga Kosova si dhe vepra të zgjedhura të autorëve botërorë,

si Shekspiri, Gëte, veprat e autorëve nga antikiteti, etj. “Rilindja” është marrë gjithashtu edhe me forma të ndryshme të afirmimit të krijimtarisë origjinale të autorëve shqiptarë dhe me përhapjen e librit shqip nëpër botë, duke furnizuar bibliotekat më të njohura të botës me botimet e veta dhe duke marrë pjesë nëpër panaire të ndryshme ndërkombëtare. Pas dhunës së vitit 1990 ajo vazhdoi me shumë probleme aktivitetin gjysmëklandestin, pa shumë fonde për të realizuar planet e veta botuese, për t’u shuar përfundimisht në fillim të viteve 2000 dhe për t’ua lënë vendin shtëpive botuese private që u krijuan pas saj. (Eqrem Basha)

SHTËPIA BOTUESE “ROZAFI”. Shtëpi botuese e themeluar më 1997 nga Sali Bashota dhe Ramadan Mehmeti. Nga themelimi deri më 1999 nuk ka zhvilluar ndonjë aktivitet kulturor, pos botimit të disa veprave me poezi dhe tregime. Në vitet 2000-2004 realizoi projekte botuese dhe aktivitete kulturore me emërtimin Fondacioni për Lidhje Letrare dhe Kulturore “Rozafa”. Në këtë drejtim janë organizuar tribuna letrare dhe tribuna shkencore me shkrimtarët më të njohur bashkëkohorë të Kosovës, si dhe janë botuar vepra origjinale, vepra të përkthyer, antologji të ndryshme etj. Nga viti 2004, me bibliotekat e emëtuara sipas shkrimtarëve të njohur të letërsisë shqipe, “Rozafa” e ka profilizuar fushëveprimtarinë e saj. Emërtimi i këtyre bibliotekave është: “Poezia (Lasgushi)”, “Proza (Kuteli)”, “Kritika (Konica)”, “Përkthimi Noli”, “Publicistika (Midhat Frashëri)”. Veprimtaria botuese është ndër prioritetet e saj, duke nxitur dhe përkrahur krijuesit e rinj, por edhe duke botuar vepra të rëndësishme të autorëve më të njohur shqiptarë. Aktivitetet e saj janë mbështetur nga institucione vendore e ndërkombëtare, kryesisht me botimin e librave. Nga themelimi deri më sot ka botuar afër 400 tituj veprash të llojeve dhe zhanreve të ndryshme. (Eqrem Basha)

SHTËPIA FILMIKE “KOSOVAFILMI”. Institucion për prodhimin, shpërndarjen dhe shfaqjen e filmave, i themeluar në vitin 1969. Kinematografia e Kosovës është e lidhur kryekëput me këtë institucion, si e vetmja shtëpi filmike e Kosovës në ish-Jugosllavi. “Kosovafilmi” ka xhiruar 35 filma artistikë, dokumentarë, vizatimorë dhe të metrazhit të



GODINA E "KOSOVAFILMIT"

shkurtër. Në periudhën e parë realizoi filma me regjisorë e producentë nga ish-Jugosllavia, ndërsa më vonë bëri filma të pavarur, duke angazhuar regjisorë, aktorë e kineastë nga Kosova, të specializuar në kryeqendrat e ish-Jugosllavisë. Filmi "Uka i Bjeshkëve të Nemuna" është filmi i parë i xhiruar në Kosovë, me pjesëmarrjen më të madhe të ekipit realizues nga Kosova, me skenaristët Abdurrahman Shala dhe Murteza Peza, ndërsa regjia e filmit dhe një sërë profilesh të tjera vinin nga hapësirat e ish-Jugosllavisë. Nga kjo fazë e prodhimit të "Kosovafilmmit" janë edhe filmat: "Dashuria e parë", "Rekuem", "Koka ime e krisur", "Si të vdiset", "Bombahedhësit", "Sulmi i kuq", "Dervishi dhe vdekja" dhe "Majat e Zelengorës". Ndërkaq, me filmin "Era dhe lisi" (1979, prodhim i "Kosovafilmmit" dhe TV Prishtinës), sipas skenarit të Petrit Imamit, në regji të Besim Sahatçiu, nis një kapitull i ri i prodhimit të pavarur. Është film me regjisor, aktorë, drejtor fotografie dhe profile të tjera nga Kosova. Po këtë vit u shfaq në festivalin e Pulës edhe filmi tjetër i "Kosovafilmmit", "Kur pranvera vonohet", në regji të Ekrem Kryeziut. "Kosovafilmi" vazhdoi me sukses prodhimtarinë me filmat: "Duart e pastra", "Gjurmë të bardha", "Lepuri me pesë këmbë", "Përroi vërshues", "Njeriu prej dheu", "Pikniku", "Proka" dhe "Rojet e mjegullës". Ndërkaq, sektori i shpërndarjes, i themeluar në vitin 1971, bëri importimin e filmave të huaj, të cilët janë shfaqur në kinematë e ish-Jugosllavisë. Nga sektori i distribuimit janë importuar rreth 200 filma artistikë, kryesisht nga SHBA-ja, Franca, Italia, Gjermania, Turqia dhe Shqipëria. Drejtori i parë i "Kosovafilmmit" ishte Abdurrahman Shala, ndërsa pas tij Azem

Shkreli, të cilit i takon merita kryesore për pavarësimin e prodhimit të "Kosovafilmmit". Filmat e prodhuar nga "Kosovafilmi" morën një sërë çmimesh në festivalet jugosllave, si: "Arena e artë" për skenarin dhe rolin kryesor në filmin "Era dhe lisi" në Festivalin "Pula 1979", çmimin e kritikëve të filmit në Festivalin "Sarajeva 1979"; pastaj "Arena e bronzit" për filmin "Gjurmë të bardha" në Festivalin "Pula 1980", si dhe çmimin kryesor për filmin dokumentar "117" në festivalin e filmit dokumentar dhe të metrazhit të shkurtër në Beograd (1978) etj. Në kohën e suprimimit të autonomisë (1989) dhe më pas, "Kosovafilmi" nuk prodhoi më asnjë film, ndërsa në periudhën e pasluftës u përball me probleme organizative dhe buxhetore. Edhe në këto rrethana u bënë filmat dokumentarë: "Doket dhe zakonet e shqiptarëve të Malit të Zi", "Na ishte një herë Kosovafilmi", ndërsa me filmin artistik të metrazhit të gjatë "Kukumi" (2005), në regji të Isa Qosjes, "Kosovafilmi" mori pjesë në 66 festivale ndërkombëtare dhe filmi u vlerësua me 15 çmime kombëtare dhe ndërkombëtare. (Gani Mehmetaj)

SHTËPI-SHKOLLAT. Shkolla të vendosura në objekte private në Kosovë, për shkak të dëbimit të nxënësve shqiptarë nga objektet legale, nga autoritetet shtetërore serbe. Puna në



NJË SHTËPI-SHKOLLË NË VITET '90

shtëpi-shkolla filloi në vitin shkollor 1991/92, kur mësimi në gjuhën shqipe u pengua në të gjitha nivelet. Projektin për mbrojtjen e arsimit në gjuhën shqipe e hartoi Enti Pedagogjik i Kosovës, mbështetur nga të gjitha instancat dhe subjektet politike të Kosovës, përfshirë edhe Qeverinë e Përkohshme të Kosovës në emigrim. Strategjinë me modalitetin shtëpi-shkolla dhe planet dhe programet mësimore

për rrethanat e krijuara e miratoi Pleqësia e Arsimit në vitin 1991. Strategjia parashikonte zhvillimin e mësimin jashtë objekteve të uzurpuara nga autoritetet serbe, në shtëpi private, në institucione të bamirësisë, në objekte private të pashfrytëzuara, në institucione fetare etj. E para shkollë që filloi mësimin sipas kësaj strategjie ishte gjimnazi “Xhevdet Doda” në Prishtinë, i cili filloi mësimin më 6 janar 1992 në shtëpinë e Zijadin Gashit. Në shkolla të tilla funksionuan kryesisht shkollat e mesme të Kosovës dhe njësitë e Universitetit të Prishtinës. Shtëpi-shkollat vazhduan deri më 24 mars 1999, kur filluan bombardimet e NATO-s në caqet ushtarake dhe policore serbe. Financimi i këtyre shkollave bëhej përmes kontributeve vullnetare, përmes skemës së vetëfinancimit, përmes fondacioneve të ngritura brenda dhe jashtë vendit, si dhe të mjeteve financiare të grumbulluara nga Qeveria e Kosovës në emigrim. (Halim Hyseni)

SHTËRPCA. Qytezë dhe qendër e komunës me të njëjtin emër. Është vendbanimi më i madh i krahinës së Zhupës. Shtrihet në lindje të Prizrenit, përgjatë rrugës automobilistike Prizren-



SHTËRPCA

Ferizaj, në lartësi mbidetare 860 m. Deri në vitin 1956 ishte qendër komunale, që integronte disa vendbanime përreth. Në vitin 1966 humbi funksionet e qendrës komunale dhe bashkohet me Ferizajn, për t'u ndarë përsëri në vitin 1988. Që atëherë funksionon si njësi komunale më vete. Përmendet në dokumentet e shkruara (1455) me emrin Shtërpçe. Në sallnamet e Vilajetit të Kosovës, në vitin 1893, është regjistruar me emrin Ishterice. Popullsia shumicë serbe është e ardhur nga Pollogu i Maqedonisë, Mali i Zi si dhe nga rrethina e Pejës dhe e Prizre-

nit. Derisa në vitin 1948 Shtërpca kishte 1,630 banorë, në vitin 2011 ajo kishte 1,265 banorë. Me avancimin e statusit administrativ në nivelin e qendrës komunale fitoi edhe funksionet arsimore e shëndetësore. Është qendër administrative, politike, ekonomike, shëndetësore dhe arsimore e 16 vendbanimeve përreth që gravitojnë në të. Nga objektet dhe infrastruktura shoqërore ka administratën komunale, qendrën e mjekësisë familjare, stacionin e policisë, gjykatën themelore, qendrën për punë dhe mirëqenie sociale, shtëpinë e kulturës, bibliotekën, njësi bankare, shkollën fillore dhe të mesme, tregun dhe objekte hoteliere etj. Në aspektin ekonomik më tepër paraqet një qendër agrare. Zhvillimi ekonomik mbështetet në bujqësi, tregti, turizëm dhe grumbullimin e frutave malore. (Hasim Kryeziu)

SHTËRPCA (komuna). Komunë në pjesën jugore të Kosovës. Shtrihet në të dy anët e luginës së lumit të Lepencit, në zonën e Zhupës së Siriniqit dhe të Sharrit. Në veri kufizohet me komunën e Ferizajt, në perëndim me atë të Prizrenit, në lindje me Kaçanikun dhe në jug me Republikën e Maqedonisë. Territori i saj zë sipërfaqen prej 247.4 km², ose afro 2.3% të territorit të Kosovës. Në pikëpamje gjeografike territori i komunës përbëhet prej dy zonave të veçanta: zonës së Sharrit dhe asaj të Siriniqit. Në perëndim kufizohet me malin Oshlak dhe të Jezercit (mbi 2000 m), në veri me malin e Nerodimës (1700 m), kurse në jug me malet e Sharrit (Luboteni 2496 m, Livadica 2491 m dhe Bistrica 2640 m). Konfiguracioni i terrenit është mjaft i përthyer nga grykat e luginat e thella malore, të cilat kushtëzojnë praninë e klimës, hidrografisë dhe bimësisë specifike. Klima është tipike malore. Në viset e larta malore, temperatura mesatare vjetore e ajrit sillet prej 8-9°C, kurse në pjesët më të ulëta deri 10°C. Në stacionin e Brezovicës temperatura mesatare vjetore e ajrit është matur 7.3° C. Reshjet më të shumta bien gjatë vjeshtës dhe pranverës. Reshjet e borës janë dukuri e zakonshme. Sasia e reshjeve sillet prej 800 mm në veri deri në mbi 1000 mm në vit në zonën e Sharrit në jug. Lumi kryesor është Lepenci, i cili buron në shpatet perëndimore dhe jugore të maleve që e rrethojnë komunën. Në viset e larta malore ndodhen disa liqene me origjinë akullnajore. Më i madhi është Liqeni i Livadicës (228 m i gjatë, 120 m i gjerë dhe

7.3 m i thellë), Liqeni i Jazhincës në kreshtën e Sharrit etj. Sipërfaqe të mëdha janë me pyje të rrobullit, pishës së zezë dhe ahut. Në zonën e Sharrit dhe të Siriniqit pyjet zënë rreth 44% të sipërfaqes, kullosat alpine 30%, ndërsa tokat bujqësore 26% të sipërfaqes së përgjithshme të komunës. Numri i popullsisë në vitin 2011 ishte 6,949 banorë, ndaj 9,573 banorëve, sa kishte në vitin 1948. Nga lëvizja e numrit të popullsisë brenda periudhës 1948-1991 shënon rritje të vazhdueshme, ndërsa nga viti 1991 e tutje numri i popullsisë së Shtërpçës shënon ngecje dhe rënie. Shtërpca ka gjithsej 16 vendbanime të vendosura kryesisht në lugina dhe tarraca lumore, përgjatë shpateve të maleve. Në aspektin morfologjik i takojnë tipit të grumbulluar, por ka edhe të tipit të shpërndarë sipas lagjeve. Në aspektin ekonomik është komunë agraro-blegtorale. Degë gjithnjë e më e rëndësishme ekonomike po bëhet turizmi. (Hasim Kryeziu)

SHTIMI NATYROR. Paraqet raportin në mes të lindshmërisë (natalitetit) dhe vdekshmërisë (mortalitetit). Shprehet me promil. Kur shkalla e lindshmërisë është më e lartë se shkalla e vdekshmërisë, atëherë kemi shtim natyror të popullsisë. Kur vdekshmëria dhe lindshmëria kanë shkallë të barabartë, atëherë kemi ngecje në shtimin e popullsisë, e kur vdekshmëria është më e lartë se lindshmëria, atëherë kemi regres apo zvogëlim të popullsisë. Kosova, ndonëse në rrethana të vështira historike, politike, sociale dhe ekonomike, vazhdimisht ka shënuar shtim natyror pozitiv. Në disa periudha kohore, kur zvogëlohet dukshëm shkalla e vdekshmërisë, ndërsa shkalla e lindshmërisë mbetet e lartë, reflektohet në shkallë mjaft të lartë të shtimit natyror. Pas viteve '60 e deri në fund të shekullit të kaluar, Kosova ka shënuar shkallë të shtimit natyror mbi 30 promilë. Sipas vlerësimit të Agjencisë Statistike të Kosovës gjatë vitit 2013 në Kosovë kanë lindur 29,327 banorë, ndërsa kanë vdekur 7,315 banorë. Së këndejmi, shtimi natyror është 22,012 banorë, apo rreth 12 promilë. (Hazer Dana)

SHTIMJA. Qytezë dhe qendër e komunës me të njëjtin emër. Nndodhet rreth 30 km larg Prishtinës dhe po aq larg Prizrenit. Shtrihet përgjatë rrugëve kryesore Prishtinë-Prizren dhe Ferizaj-Prizren. Territori i qytezës ka sipërfaqe prej 12.4 km². Qyteza e Shtimes



SHTIMJA

nga aspekti administrativ është e ndarë në dy bashkësi lokale që përfshin zonat I, II, III, IV, V, fshatrat: Davidovc, Belincë, Reçak dhe Zborc. Si vendbanim përmendet në disa dokumente të shkruara që nga shekulli XIV. Gjatë periudhave të ndryshme historike e hasim me emrin Istimije, Shtimnja, Shtimlje dhe Shtimje. Me emrin Shtimja është regjistruar në sallnamet e vilajetit të Kosovës (1893, 1896 dhe 1900). Në fund të shekullit XIX kishte 30 shtëpi shqiptare, 30 serbe dhe 40 rome. Sipas regjistrimit të vitit 1948 kishte 2,003 banorë, ndërsa në vitin 2011 kishte 7,255 banorë. Shtimja është qendër komunale, ku gravitojnë 23 vendbanime përreth, ka administratën komunale, qendrën e mjekësisë familjare, spitalin rehabilitues, shkollën fillore dhe të mesme, shtëpinë e kulturës, bibliotekën e qytetit etj. Veprimtaritë kryesore ekonomike janë: zejtaria, tregtia, bujqësia, pemëtaria, ndërmarrjet e vogla, eksploatimi i gurit për ndërtimtari etj. (Shpend Agaj)

SHTIMJA (komuna). Komunë në pjesën qendrore të Kosovës. Kufizohet me komunën e Ferizajt, Lipjanit dhe Suharekës. Ka pozitë të volitshme gjeografike, meqenëse nëpër territorin e saj kalojnë vijat e rëndësishme të qarkullimit rrugor Prizren-Prishtinë dhe Prizren-Ferizaj- Shkup. Sipërfaqja e komunës është 134 km², me 23 vendbanime, përfshirë edhe qytezën e Shtimes. Territori i komunës ishte i banuar që herët. Në dokumentet mesjetare ajo për herë të parë përmendet në vitin 1326, kur Stefan Deçani nga oborri i tij mbretëror në Shtime lëshon diploma për dubrovnikasit "in laco disto Stimni". Gjatë vitit 1810 këtu zhvillohet beteja kundër forcave osmane, të drejtuara nga Dervish Pasha. Para

se të fitonte rolin e komunës, ishte bashkësi lokale në kuadër të komunës së Ferizajt. Statusin e komunës e fitoi në vitin 1988. Sipas regjistrimit të parë (1988), komuna kishte 25,300 banorë, ndaj 27,300 banorë sa ka tani (2011), me dendësinë e banimit prej 203 b/km². Është komunë tipike agrare. Popullsia merret me bujqësi, blegtori, pylltari, bletari, zeje të ndryshme dhe tregti. (Shpend Agaj)

SHTIMJA Ahmet (1887-1923). Veprimtar i lëvizjes kombëtare në fillim të shekullit XX. Ahmet Mulla Syla, i njohur në popull si Ahmet Shtimja, lindi në Shtime dhe u shkollua në Prizren. Ishte nënprefekt në Ferizaj (1906-1908) dhe njëri ndër organizatorët e Kuvendit të Ferizajt (1908). Mori pjesë në kryengritjen e përgjithshme antiosmane të vitit 1912. Mbante lidhje dhe bashkëpunoi me Hasan Prishtinën. Në periudhën 1916-1918 ishte kryetar komune në Shtime. Më 1919 u zgjodh anëtar i kryesisë së partisë “Xhemieti”. Më 1921 u zgjodh sërish kryetar komune në Shtime. Në vitin 1923, në takimin në Shkup të kryeministrit të Mbretërisë Serbe-Kroate-Slllovene, Nikolla Pashiq, me kryetarët e komunave, A. Shtimja kërkoi që xhandarmëria dhe rojet e pyjeve të jenë në përpjestim me popullsinë, administrata të ketë nëpunës shqiptarë, si dhe hapjen e shkollave shqipe. Këto kërkesa bënë që në Ferizaj të pritej me miting. Pas disa ditësh, në një aksion të kurdisur në Grykën e Topillës, xhandarmëria serbe e vrau bashkë me truporjën e tij. (Liman Rushiti)

SHTOKAVISHTJA. Është një ndër tri dialektet themelore të gjuhës serbe, si edhe kajkavishtja dhe çakavishtja. Flitet në Republikën e Serbisë, në Bosnjë dhe Hercegovinë, në Mal të Zi dhe në një pjesë të madhe të Kroacisë. Shtokavishten e gjejmë edhe në pjesë të tjera jashtë kufijve të këtyre shteteve. Në të kaluarën shtokavishtja nuk është shtrirë në një territor kaq të madh, por territori i saj është zgjeruar për shkak të rrethanave të ndryshme historike, në dem të dy dialekteve të tjera. Emërtimin shtokavishte e ka marrë sipas formës së përemrit lidhor-pyetës për sende, në shtokavishte što, në çakavishte ça dhe në kajkavishte kaj. Shtokavishtja zakonisht ndahet sipas reflekseve themelore të tingullit të vjetër *jat* (ѣ), i cili në shkrimin latin shënohet me shkronjën ě. (Naile Mala-Imami)

SHTUFI Kristë (1974-). Mësimdhënës i filozofisë në Universitetin e Prishtinës. Lindi në fshatin Shpinadi të Prizrenit. Shkollimin fillor e mbaroi në Velezhë, Prizren, kurse gjimnazin klasik në Shkup dhe në Suboticë (1993). Studimet e filozofisë i filloi në Fakultetin e Teologjisë në Zagreb, më pas i vazhdoi studimet e teologjisë katolike në Universitetin e Gracit në Austri. Më 1995 i filloi studimet e filozofisë shekulare me kombinim lëndësh, e më 2001 magjistroi nga fusha e filozofisë. Nga viti 2002 deri 2004 punoi asistent për hulumtime në departamentin e filozofisë në Universitetin e Gracit. Ndërkohë zgjidhet në departamentin e filozofisë të Universitetit të Prishtinës si bashkëpunëtor i jashtëm, ndërsa nga viti 2007 bëhet mësimdhënës i rregullt për disa lëndë: logjikë simbolike, filozofi e shkencës, filozofi analitike, filozofi e mesjetës dhe e renesancës etj. Në vitin 1999 K. Shtufi themeloi revistën “Fryma e filozofisë” dhe për tri vjet ishte kryeredaktor i saj. Përktheu disa vepra filozofike nga gjermanishtja dhe anglishtja. (Valon Leci)

SHTUPELI. Fshat në komunën e Klinës, 6 km në verilindje të saj. Shtrihet në lartësi mesatare mbidetare 500 m. Përmendet si vendbanim në disa dokumente mesjetare. Me emrin Shtupel e Shtupal përmendet në defterin turk të sanxhakut të Shkodrës. Në vitin 2011 Shtupeli kishte 771 banorë, ndaj 631 banorëve në vitin 1948. Është vendbanim i tipit të shpërndarë. Popullsia merret me bujqësi ekstensive, tregti etj. Është bashkësi lokale, në të cilën gravitojnë vendbanimet: Shtupel, Kërrnicë, Grabc dhe Binxhë. Nga objektet e standardit shoqëror ka shkollën 9-vjeçare, stacionin shëndetësor, disa njësi tregtare etj. (Ferim Gashi)

SHUFLAJ (Šufflay) Milan (1879-1931). Historiani kroat, albanolog. Lindi në Lepoglavë të Kroacisë. Shkollën fillore e mbaroi në vendlindje, ndërsa gjimnazin klasik në Zagreb. Studioi shkencat shoqërore në Universitetin e Zagrebit. U doktorua në vitin 1901. Deri në vitin 1908 punoi si asistent në Muzeun Nacional në Budapest. Më pas në Vjenë u specializua për paleografi latine, diplomaci,



MILAN SHUFLAJ

kronologji dhe notariat. Më 1908 filloi të punonte në Universitetin e Zagrebit dhe më 1912 u zgjodh profesor i historinë mesjetare në këtë universitet. Nga viti 1904 nisi të merrej intensivisht me historinë shqiptare të periudhës së mesjetës. Disa vjet pas botimit të dy vëllimeve të veprës “Akte dhe diploma që ilustrojnë çështjen e Shqipërisë mesjetare” (1913, 1918), që e kishte përgatitur për shtyp së bashku me K. Jireček-un dhe L. Thallóczy, Akademia e Shkencave e Austrisë i propozoi Shuflajt ta vazhdonte vjeljen e lëndës arkivore dhe t’i përgatiste për botim vëllimet III-V të kësaj vepre. Kjo iniciativë u përkrah edhe nga qeveria e Mbretërisë Shqiptare. Ndërkohë, anëtarët e organizatës “Jugosllavia e re”, e cila vepronte në Zagreb si dorë e zgjatur e regjimit serb, e pritën Shuflajn para shtëpisë së tij në mbrëmjen e 18 shkurtit të vitit 1931 dhe ia thyen kafkën me çekan. Vrasësit hynë edhe në banesë dhe e rrëmbyen dorëshkrimin e gatshëm për botim të vëllimit III të “Codex diplomaticus regni Dalmatiae, Croatiae et Slavoniae”. Vdiq një ditë më vonë dhe u varros në varrezat Mirogoj të Zagrebit. Shuflaj është autor i shumë veprave për Shqipërinë dhe shqiptarët: “Biologjia e popullit të shqiptarëve” (München, 1916.); “Gjendja e kishave në Shqipërinë paraturke” (Zagreb 1915, Budapesht, 1916); “Qytete dhe kështjella të Shqipërisë, kryesisht gjatë mesjetës” (Vjenë-Leipzig, 1924.); “Serbët dhe Shqiptarët, simbioza e tyre në mesjetë” (Beograd-Lubjanë, 1925, Tiranë 1926), romani historik në tri pjesë, “Kostadin Balsha “ (Zagreb, 1920), që u botua me pseudonimin Alba Limi. (Skënder Gashi)

SHUKRIU Ali (1919-2005). Funkionar i lartë komunist në Kosovë, pjesëmarrës i Luftës Nacionalçlirimtare. Lindi në Mitrovicë. Mësimet fillore dhe të mesme i kreu në Mitrovicë, ndërkaq e studioi mjekësinë në Universitetin e Beogradit para Luftës së Dytë Botërore. Iu bashkëngjiti lëvizjes komuniste jugosllave në vitin 1939. Gjatë Luftës së Dytë Botërore u angazhua në organizimin dhe në përhapjen e ideve komuniste dhe të luftës antifashiste sidomos te popullsia shqiptare e Mitrovicës dhe rrethinës. Ishte caktuar delegat në Konferencën e Bujanit, por nuk mori pjesë për shkak të rrethanave të luftës. Pas luftës ishte prokuror publik në Prishtinë (1945), ku u dallua për dënime të rënda ndaj kundërshtarëve politikë. Më pas kreu Shkollën e lartë politike “Gjuro

Gjakoviç” dhe më vonë ushtroi funksione të larta në pushtetin krahinor dhe qendror të ish-Jugosllavisë. Ishte nënkryetar dhe më pastaj kryetar i Këshillit Ekzekutiv të Kosovës. Gjatë viteve 1981-1982 ishte kryetar i Kryesisë të KSA Kosovës. Pas vitit 1981 u dallua për diskursin e ashpër antishqiptar dhe në mbështetje të nacionalizimit serb. Vdiq në Beograd. (Mrika Limani)

SHUKRIU Edi (1950-). Arkeologe, shkri-
mtare, profesore universiteti, anëtare korres-
pondente e Akademisë së Shkencave dhe të
Arteve të Kosovës. Lindi në Prizren, ku kreu



EDI SHUKRIU

shkollimin themelor, ndërsa studimet për arkeologji i mbaroi në Universitetin e Beogradit (1972). Doktoroi në Universitetin e Prishtinës (UP) (1990). Për shumë vjet në UP ligjëroi arkeologjinë, historinë e lindjes së lashtë e antikën dhe menaxhimin e trashëgimisë kulturore. Në periudhën 1974-1979 punoi në Muzeun e Kosovës. Përgjatë viteve 2009-2012 ishte kryetare e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore. Përveç punës shkencore në fushën e arkeologjisë, u mor edhe me letërsi. Për perfeksionim profesional bëri vizita studimore në Universitetin e Harvardit dhe në Universitetin Iowa (SHBA). U angazhua në fushën e arkeologjisë, duke themeluar më 1986 grupin e arkeologëve të rinj të UP-së, pastaj organizoi ekspedita arkeologjike dhe ekspozita tematike në koleksionin arkeologjik të Fakultetit Filozofik, siguroi pjesëmarrje të studentëve në hulumtime arkeologjike në Kosovë dhe jashtë saj. Menaxhoi dhe udhëhoqi hulumtimet arkeologjike në Ulpianë (2006-2010) në kuadër të Universitetit Veror të Prishtinës. Bëri ekspedita përnjohëse dhe evidentoi një varg lokalitetesh arkeologjike, si: Kasterci i Suharekës, Kulina e qyteti i Strezovcit te Kamenica, Qyteza e Madhe dhe Qyteza e Vogël e Batushës dhe të njëjtat të Vlashnjës, pikturimin shkëmbor të Vlashnjës, Kalanë e Poneshit etj., si dhe mori pjesë në takime të shumta ndërkombëtare, shkencore, politike dhe letrare. Mori pjesë aktive në zhvillimet politike të viteve '90 dhe më pas. Ishte njëra nga themelueset e Forumit të Gruas të Lidhjes Demokratike të Kosovës (1990) dhe

kryetare e këtij forumi (1995-2000), pastaj deputete e zgjedhur e Kuvendit të Kosovës (1992-1998) dhe deputete në legjislaturën e parë pas luftës (2002-2004), ndërsa në vitet 2000-2001 ishte bashkëdrejtuese e Departamentit të Kulturës të UNMIK-ut etj. U angazhua për pjesëmarrjen e femrës në nivelet e vendimmarrjes dhe jetësimin e barazisë gjinore. Nga fusha e arkeologjisë dhe historisë botoi librat “Hyjnesha Dardane” (2014), “Kisha e Shën Prendës, Prizren” (2012), “Kosova antike” (2004, shqip dhe anglisht), “Dardania paraurbanë” (1996), “Gra të shquara shqiptare” (2000) etj., shumë artikuj shkencorë dhe libra letrarë, si përmbledhjet e poezive: “Sonte zemra ime feston”, Gjakim”, “Legjenda e Hasit”, “Përjetësi” etj. dhe dramat: “Kthimi i Euridikës”, “Lkeni i Hasit” etj. (Arben Arifi)

SHUKRIU Muhamed (1926-2010). Studiuues dhe aktivist i mbrojtjes së trashëgimisë historike dhe kulturore. Lindi në Prizren, ku kreu shkollimin fillor dhe të mesëm, ndërsa



MUHAMED
SHUKRIU

Fakultetin Juridik e përfundoi në Universitetin e Prishtinës. Gjatë Luftës së Dytë Botërore ishte partizan në Brigadën VII Nacionalçlirimtare të Kosovës. Pas lufte punoi si referent në Gjykatën e Prizrenit. Ishte themelues dhe drejtor i Entit për Mbrojtjen e Përmendoreve Kulturore të kësaj komune (1967) dhe të Muzeut të Revolucionit të Kombeve dhe të Kombësive të KSA të Kosovës. Në vitin 1981, për motive politike, u nxor në pension të parakohshëm. Gjatë kohës që punoi në Entin e Monumenteve të Prizrenit, themeloi Muzeun e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Muzeun Arkeologjik të Rajonit të Prizrenit dhe Muzeun e Elektroekonomisë së Kosovës po në Prizren, të parin e këtij lloji në rajon. Organizoi përnjohje arkeologjike dhe gërmimet në Kalanë e Prizrenit (1969), në tumat e Romajës (1970), në lokalitetin arkeologjik të Vërmicës (1974-1975) etj. Me bashkëpunëtorët përpiloi projekte studimore për Kalanë e Prizrenit, Luginën e Drinit të Bardhë nga Gjonaj, menaxhoi studimin antropologjik të nekropolit mesjetar të Vërmicës, si dhe të hapjes së varrit të Y. Prizrenit në Ulqin, përfshirë edhe rikonstruktimin e pamjes së tij.

Pas hulumtimeve shumëvjeçare (1973-1998) zbuloi në Podgoricë varrin e Isa Boletinit dhe të bashkëlufëtareve të tij dhe i sollti eshtrat në Kosovë. Gjithashtu, gjeti varrin e Abdyl Frashërit në Turqi dhe i bëri presion Shqipërisë që t'i merrte mbetjet e tij mortore. Në vitin 1991 ishte njëri prej nismëtarëve të themelimit të Shoqatës Gjithëshqiptare për Ruajtjen e Monumenteve Kulturore-Historike me seli në Prizren. Pas çlirimit të Kosovës u emërua drejtor i Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve Kulturore të komunës së Prizrenit (1999-2001). Në vitin 2001 botoi monografinë “Prizreni i lashtë: morfologjia e ecurive për ruajtjen e kulturës materiale” (2001). Për veprimtari në fushën e trashëgimisë kulturore u dekorua nga presidenti i Kosovës me “Medalje të Artë” (2000). (Parim Kosova)

SHUNJEVIQ Çedo (Čedo Šunjević) (1930-2012). Shkrimtar i letërsisë serbe nga Kosova, gazetar. Lindi në Dapsiq afër Beranës në Mal të Zi. Kreu studimet për histori në Fakultetin Filozofik në Shkup. Ishte nga poetët e parë të poezisë për fëmijë në gjuhën serbokroate në Kosovë. Për shumë vjet punoi si profesor në Fakultetin Teknik të Prishtinës. Botoi përmbledhje poezish për fëmijë dhe të rritur: “Peizazhe, kujtesa dhe pjekuritë” (1969), “Rritja nga pragu i vdekjes” (1971), “Shtegut të diellit” (1976), “Lulëkuqet” (1982). Mori disa çmime në konkurse letrare për poezi dhe prozë dhe për kontributin e tij në fushën e krijimtarisë letrare për fëmijë. Në gjuhën shqipe u përkthyen vepra e tij me poezi për fëmijë: “Dhuratat vjeshtore” (1975). (Ismet Markoviq)

SHUPERKA Partizan (1945-). Ekonomist, profesor universiteti. Lindi në Prizren, shkollimin fillor dhe të mesmin e mbaroi në vendlindje, studimet i filloi në Prishtinë dhe i përfundoi në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Beogradit (1967). Studimet pasuniversitare i përfundoi në vitin 1970, ndërsa doktoratën e mbrojti një vit më vonë, me temën “Teknika moderne dhe fenomeni i shoqërorizimit”. Në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës filloi punë në vitin 1972 dhe vazhdoi me angazhim deri në pensionim, duke ligjruar lëndët ekonomia e industrisë, ekonomia e bujqësisë, teoria e zhvillimit ekonomik dhe sistemet ekonomike, teoria dhe politika e zhvillimit ekonomik etj. P. Shuperka bëri edhe punë

shkencore me një numër studimesh të botuara në të përkohshmet brenda dhe jashtë vendit. Për nevojat e studentëve ka përkthyer tekste universitare dhe ka kryer detyra me përgjegjësi në institucione të ndryshme. Si prodekan i Fakultetit Ekonomik ka dhënë një kontribut të veçantë në periudhën e okupimit serb dhe në organizimin e procesit mësimor jashtë objekteve publike. (Ramiz Livoreka)

SHURDHANI Ismet (1942-). Gjyqtar i futbollit. Lindi në Kaçanik. Karrierën sportive e nisi që në moshë të re, si portier në KF "Lepenci" të Kaçanikut. Në vitin 1969 dha provimin për gjyqtar fillestar, kur ende ishte futbollist aktiv. Në vitin 1974 mori titullin e gjyqtarit të kategorisë së dytë, kurse në vitin 1977 edhe titullin e gjyqtarit të kategorisë së parë. Ishte gjyqtar aktiv i futbollit deri në vitin 1987. Ka qenë gjyqtar në shumë ndeshje të Ligës së parë të ish-Jugosllavisë, por edhe në futbollin ndërkombëtar. Për shumë vjet ishte ndër drejtuesit e Shoqatës së Gjyqtarëve të Futbollit të Kosovës dhe anëtar i komisionit disiplinor në Federatën e Futbollit të Kosovës. Me gjyqtarin Shinasi Berisha është bashkautor i librit "Rregullat e lojës së futbollit". (Baki Berisha)

SHUSHKA Jusuf (1928-2009). Pedagog, mësimdhënës, veprimtar i arsimit. Lindi në fshatin Krojmir, komuna e Lipjanit. Shkollën fillore e kreu në Shalë (ish-Sedllar), shkollën normale në Gjakovë. Studimet për pedagogji i vijoi në Universitetin e Beogradit, ndërsa diplomoi në degën e pedagogjisë të Fakultetit Filozofik në Prishtinë. Fillimisht ishte mësues në fshtin Kraishtë të Lipjanit, pastaj profesor në Shkollën Normale të Gjakovës, përkatësisht të Prishtinës, mësimdhënës dhe drejtor i Shkollës së Lartë Pedagogjike të Prishtinës. Kreu edhe detyra të tjera në institucionet e arsimit. Ishte bashkautor dhe përkthyes i disa teksteve mësimore të shkollës fillore. (Hajrullah Koliqi)

SHYC Ishtvan (Istvan Schütz) (1923-2010). Albanolog hungarez. Lindi në një fshat rumun në kufi me Hungarinë. Pas Luftës së Dytë Botërore u vendos në Hungari, ku vazhdoi stu-



ISHTTVAN SHYC

dimet universitare për gjuhë dhe letërsi hungareze dhe latine. Menjëherë pas përfundimit të studimeve, në vitin 1948, ra në kontakt me gjuhën shqipe dhe me kulturën shqiptare. Prej atij viti ai zhvilloi një veprimtari të gjerë mësimore e shkencore. Për një kohë të gjatë ishte mësimdhënës i gjuhës dhe letërsisë shqipe në Universitetin Lorant Etvos në Budapest dhe hartoi fjalorin e parë shqip-hungarisht (1953). Përveç këtij fjalori të parë, pas një pune prej gjysmë shekulli, përfundoi edhe një fjalor tjetër shqip-hungarisht, i cili përmban mbi 80,000 fjalë. Krahas punës leksikografike, botoi edhe një gramatikë të shqipes për hungarezë: "Libri i gjuhës shqipe" (2002). I. Shyc është marrë sistematikisht edhe me çështje të gjuhësisë ballkanike dhe të lidhjeve gjuhësore shqiptaro-rumune. Bëri vëzhgime dhe në fushën e folklorit, të etnografisë dhe të besimeve popullore. Ishte i njohur dhe si publicist aktiv në mediet hungareze për çështjen e shqiptarëve. Përktheu në hungarisht një varg veprash të shkrimtarëve të sotëm shqiptarë dhe shprehu mendime vlerësuese për letërsinë shqipe. (Kadire Binaj)

SHYTI Mustafë (1945-1999). Veprimtar, luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), dëshmor. Lindi në fshatin Oshlan të Vushtrrisë. Studioi për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Ishte pjesëmarrës në demonstratat e vitit 1981 dhe 1988/89. Punoi si mësues në Oshlan nga viti 1972. Për shkak të pikëpamjeve politike, ishte i përndjekur nga organet shtetërore të kohës. Në vitin 1998 i bashkohet UÇK-së në Zonën Operative të Shalës. Mori pjesë aktivisht në mobilizimin e vullnetarëve. Ra në front të luftës më 24 shtator 1998. Po atë vit botoi përmbledhjen me poezi "Dallgë jete", ndërsa pas vdekjes iu botua vepra "Pranverë gjaku" (2001). Për veprimtarinë e tij patriotike nga institucionet e Kosovës iu ndanë mirënjohje dhe dekorata të shumta. (Sabit Sylja)

T

TABULA PEUTINGERIANA. Hartë e rrjetit të rrugëve të Perandorisë Romake, e cila mbulononte Europën, Afrikën Veriore dhe një pjesë të Azisë (Lindjen e Mesme, Persinë dhe Indinë). Harta e Peutingerit është një nga burimet më të çmuara të periudhës antike. Hyn në grupin e tabelave grafike (tabula picta). E përpiluar në shek. IV dhe e bazuar në një traditë të pasur të hartografisë romake, pasqyron gjendjen e kësaj periudhe, ku janë paraqitur një varg të itinerareve, të vendbanimeve, të liqeneve, lumenjve, maleve, si dhe distancat në milje në mes të stacioneve rrugore. Harta u zbulua në shek. XV nga humanisti Konrad Keltis (1459-1508) dhe iu dorëzua Konrad Peutingerit (1459-1508), andaj e mban emrin Harta e Peutingerit. Segmenti i shtatë i hartës pasqyron Ballkanin Perëndimor, përfshirë rrugën Lissus-Naissu, ku gjenden emrat e stacioneve rrugore si Naisso, Ad Herculem, Hammeo, Ad Fines, Vindenis, Viciano, Theranda, Gabuleo etj. Në të gjenden dhe emrat e qyteteve të territorit ilir, si: Apollonia, Durrësi, Lisi, Aulona, Skodra, Hadrianopoli etj. Harta dëshmon integrimin edhe të territoreve ilire në infrastrukturën rrugore romake. Ruhet në Bibliotekën Nacionale të Vjenës. (Arben Hajdari)

TAFAJ Skender (1948-2017). Aktor. Lindi në Isniq të Deçanit. Studimet e aktrimit i kreu në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prishtinë. Në Teatrin Krahinor të Kosovës u inkuadrua më 1969. Luajti role me rëndësi në shumë shfaqje të këtij teatri. Personazhet e tij skenike shquheshin nga një ekspresion i rrallë. Disa nga këto shfaqje ishin: “Revizori”, “Miza në vesh”, “Hotel kashta”, “Makbethi”, “Një nuse për Stasin”, “Trungu ilir”, “Hamleti”, “Gof”, “Vërbimi i Samsonit”, “Varri i qyqes”, “Shënimet e Gjon Nikollë Kazazit”, “Zogu i diellit”, “Konfiteori”,

“Princi i hijeve”, “Ventrusët” dhe “Beselam pse më flijojnë”, “Vdekja më vjen prej syve të tillë” etj. Në vitin 1988, si i përndjekur politik, u largua nga Kosova dhe u vendos në Zvicër. (Selman Jusufi)

TAFALLARI Berat (1984-). Bariton. Lindi në Prizren, ku kreu Shkollën e Mesme të Muzikës. Kreu studimet për solokëndim në Fakultetin e Arteve në Prishtinë, ndërsa ato pasuniversitare në Konservatorin e Vjenës, me repertor operistik. Në vitet 2002-2005 ishte solist në koncertet e Filarmonisë së Kosovës, pastaj me Orkestrën Mbretërore Vjeneze (2007), Event Partner Austria-Opera al Dente, Vjenë (2008-2013), me repertor rolesh operistike, si: Dulcamara (“L'elisir d'amore”), Figaro (“Le Nozze di Figaro”) e Papageno (“Die Zauberflöte”), Don Giovanni (“Don Giovanni”), Giuliermo (“Cosi fan Tutte”), Alfio (“Cavalleria Rusticana”), Marcello (“La Boheme”), Enrico (“Lucia di Lammemoor”), Malaresta (“Don Pasquale”), Falke (“Die Fledermaus”), Moruccio (“Tiefland”). Pas diplomimit fitoi bursën për të vazhduar në drejtimin e Operës në “Prayner Konservatorium”si dhe iu mundësua të vazhdojë përvojën me dirigjentin M. Cencic pranë Operës Shtetërore Austriake (“Wiener Staatsoper”) dhe me regjisoren-këngëtaren operistike Margarita Kyriaki-Wagner. Është bashkëthemelues i Ansambilit vokal të meshkujve “Okteti”. Punon pedagog i këndimit në shkollën “Asocation Loyla Gymnasium”. (Arnisa Rexhepi)

TAFARSHIKU Hysri (1944-2008). Mjek, internist, endokrinolog, mësimdhënës universitar. Lindi në Gjakovë, shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në vendlindje, u diplomua në Fakultetin e Mjekësisë në Beograd (1970),

ku gjithashtu kreu edhe specializimin. Mbrojti disertacionin e doktoratës në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. Punoi në Spitalin e Përgjithshëm në Prishtinë, ndërsa më 1976 u zgjodh asistent i lëndës mjekësia interne në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës, ku arriti titullin profesor inordinar i kësaj lënde. Mori pjesë në shumë kongrese e simpoziume dhe publikoi një sërë punimesh shkencore, si autor dhe bashkautor. (Ahmet Brovina)

TAFARSHIKU Sadik (1912-1997). Atdhetar arsimdashës. Lindi në Gjakovë, ku kreu shkollën fillore dhe një shkollë të ulët tregtare. Veprimtarinë atdhetare e filloi në vitin 1924, në shoqërinë kulturore ilegale "Agimi" në Gjakovë. Ndërkohë, fillon të shpërndajë ilegalisht edhe libra shqip, të sjellë nga Shqipëria. U lidh me shoqatën "Gajret" të Sarajevës dhe formoi degën e saj në Gjakovë (1936). Më pas, në vitin 1941, përfshihet në lëvizjen antifashiste, për çka edhe u burgos. U njoh me shumë figura politike të Luftës Antifashiste në trevat shqiptare. Pas Luftës së Dytë Botërore u mor me veprimtari të ndryshme shoqërore. Për shkak të qëndrimit kritik ndaj politikës serbe në Kosovë, u dënua me burg. Pas lirimit nga burgu u vendos në Ferizaj, ku filloi të merrej me shitjen e librave. Si shitës ambulant i librave përhapri librin shqip në të gjitha qytetet dhe në qindra fshatra anë e kënd Kosovës. S. Tafarshiku ishte protagonist ose dëshmitar i shumë ngjarjeve historike të kohës. (Hajrullah Koliqi)

TAHA Haki (1913-1945). Mësues, i dyshuar si atentator i Miladin Popoviqit. Lindi në Gjakovë. Shkollën fillore e nisi në vendlindje dhe e kreu në Krumë të Hasit në Shqipëri, gjimnazin e ulët në Shkodër, ndërsa Shkollën Normale në Elbasan (1939). Në vitin 1941, pas kapitullimit të Mbretërisë së Jugosllavisë u kthye në Kosovë me grupin e parë të mësuesve. Ndonëse antifashist nga bindja, nuk iu bashkua Lëvizjes Nacionalçlirimtare, për arsye se nuk i besonte bashkëpunimit me serbët e malazezët. Punoi si mësues. Në vitin 1942 organizoi të rinjtë e Gjakovës që kryeministrin Mustafa Kruja ta pritnin me flamur kombëtar pa shenjat fashiste dhe të kërkonin prej tij që në Gjakovë të hapej shkolla normale e jo shkolla tregtare, siç kishte vendosur qeveria e tij. Pas këtyre kërkesave publike, pranë Institutit Tregtar në Gjakovë

u hap edhe dega e shkollës normale. Pas një kohe u sëmur rëndë dhe mbeti në shtrat deri në ditët kur mori rrugën për në Prishtinë, ku u vra nga njësitet e OZN-ës në mars të vitit 1945, si i dyshuar se kishte bërë atentat në sekretarin e Komitetit Krahinor të PKJ-së për Kosovë, Miladin Popoviqin. (Haki Kasumi)

TAHIRI Abdullah (1956-1999). Veprimtar politik, nismëtar i parë për organizimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) për Anamoravë, dëshmor. Lindi në fshatin Malishevë të Gjilanit. Kreu gjimnazin në Gjilan, më pas vazhdoi studimet në Fakultetin e Bujqësisë të Universitetit të Prishtinës. Ishte një ndër organizatorët kryesorë të demonstratave të marsit dhe prillit të vitit 1981. Për shkak të veprimtarisë së tij, u arrestua dhe u dënua nga pushteti i atëhershëm. Me fillimin e luftës së armatosur, u angazhua për organizimin e UÇK-së në Gjilan dhe Anamoravë. Në pranverë të vitit 1998 qëndroi disa herë në Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së për t'i bashkërenditur punët e organizimit të Zonës Operative të Karadakut. Vuri lidhje me Kosovën Lindore dhe organizoi rrugët e para të furnizimit me armatim për këtë zonë. Për shkak këtij aktiviteti u arrestua dhe u dënua me 4 vjet burg. Në maj të vitit 1999 u ekzekutua në Burgun e Dubravës, bashkë me shumë të burgosur të tjerë shqiptarë. (Shemsi Syla)

TAHIRI Bardhyl (1955-). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), oficer karriere. Lindi në Ersekë. Në vitin 1974 filloi studimet në Shkollën e Lartë të Oficerëve, ndërsa në vitin 1978 mori gradën oficer i xhenios. Në vitet 1987-1989 vijoi studimet në Akademinë e Shtabit të Përgjithshëm në Tiranë. Në vitin 1992 u gradua kolonel dhe u emërua komandant i divizionit të xhenios në Ushtrinë Shqiptare. Në vitin 1994 kaloi oficer në rezervë. Në mars të vitit 1999 kaloi në Kosovë dhe, pasi mbërriu në malet e Berishës (Drenicë), u emërua shef i inxhinierisë së Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së. Deri në përfundim të luftës në Kosovë qëndroi në detyra të ndryshme në këtë Shtab. Në qershor të vitit 2001 i bashkëngjitet Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare në Maqedoni, duke marrë detyrën e shefit të shtabit të Brigadës 15 të UÇK-së, me qendër në Radushë-Shkup. Me mbarimin e asaj lufte u kthye në Tiranë. (Dilaver Goxhaj)

TAHIRI Dibran (1945-). Aktor. Lindi në Mitrovicë. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje. Mbaroi studimet për aktrim në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prishtinë.



DIBRAN TAHIRI

Që nga viti 1969 ishte anëtar i ansamblit në Teatrin Popullor Krahinor në Prishtinë. Luajti role të shumta në teatër, film dhe televizion. Interpretoi gjithashtu edhe në disa radiodrama. Në Teatrin Popullor Krahinor në Prishtinë luajti në role kryesore apo dytësore në shfaqjet: “Duke pritur Godonë”, “Revizori”, “Hamleti”, “Një nuse për Stasin”, “Vegullia”, “Emigrantët”, “Fosilet”, “Edipi Mbret”, “Kaligula”, “Filoktet”, “Kutia muzikore”, “Golgota”, “Shtettrrethimi”, “Makbethi”, “Ushtari i mirë Shvejk”, “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”, “Sfinga e gjallë”, “Beselam, pse më flijojnë”, “Besa e madhe”, “Genci”, “Mizantropi”, “Spiuni”, “Roja e shiut”, “Varri i qyqes” “Ahmet Koshutani”, “Confiteori”, “Derishi dhe vdekja”, “Zhvarrimi i Pjetër Bogdanit”, “Zhorzh Dandeni”, “Babai”, “Krushqit janë të ngrirë”, “Daja Vanja” etj. Pas vitit 1999 e këndej, në Teatrin Kombëtar të Kosovës në Prishtinë luajti edhe në një sërë shfaqjesh, si: “Shfaqja e fundit”, “Fausti III”, “Ëndrra e qenit”, “Korridorët e tmerrit”, “Pallati i ëndrrave”, “Rikardi III”, “Muzgu i lirisë”, “Hamleti”, “Fluturimi mbi follenë e qyqes”, “Makbethi”, etj. Përveç teatrit luajti role të rëndësishme edhe në disa filma të metrazhit të gjatë: “Si të vdiset”, “Kur pranvera vonohet” (1979), “Era dhe Lisi” (1979), “Gjurmë të bardha” (1980), “Lepuri me pesë këmbë” (1982), “Përroi vërshues” (1983), “Pikniku” (1986) etj. Luajti gjithashtu edhe në serialet televizive: “Një pallto për babain”, “Mahmutovitë dhe Rexhepovitë”, “Pa pengesa”, “Jeta e një toke”, “Familja moderne”, “Brenda drejtësisë”, “Atje ku nuk lind dielli” etj. U nderua me mirënjohje dhe çmime të ndryshme, përfshirë edhe Çmimin Kombëtar për Vepër Jetësore nga Ministria e Kulturës (2012). (Bekim Lumi)

TAHIRI Edita (1956-). Politikane. Lindi në Prizren, ku kreu shkollimin fillor dhe të mesëm, ndërkaq studimet i kreu në Fakultetin e Elektroteknikës në Universitetin e Prishtinës. Më 1983 kreu studimet postdiplomike në fushën e telekomunikacionit digjital në Essek



EDITA TAHIRI

të Britanisë së Madhe, ndërsa më 2002 mbaroi studimet pasuniversitare në Universitetin e Harvardit për qeverisje dhe administrim publik. Ishte e përfshirë edhe në programe të ndryshme studimi, kurse doktoroi në shkencat politike me tezën e doktoratës “Shtetndërtimet ndërkom-bëtare në rrethanat e sovranitetit të papërcaktuar”. Ishte anëtare e kryesisë së Lidhjes Demokratike të Kosovës (1991-1998), deputete e Kuvendit të Kosovës (2001-2004), pjesëmarrëse në Konferencën e Londrës (1992) dhe në Konferencën e Rambujesë (1999), si dhe pjesë e ekipeve për negociata me Serbinë, G15 dhe G5. Më 2004 themeloi partinë politike Alternativa Demokratike e Kosovës dhe, si kryetare e saj, mori pjesë në parlament në zgjedhjet e vitit 2007. Ishte zëvendëskryeministre, ministre e Administratës Publike, kurse së fundi ishte ministre për negociatat me palën serbe në dialogun e Brukselit. Botoi disa monografi, nga të cilat veçohen: “Konferenca e Rambujesë: procesi negociator dhe dokumentet” (2001), “Pavarësia e Kosovës faktor stabiliteti për Europën Juglindore” (2001), “Pavarësia e Kosovës-kontribut për stabilitetin e rajonit” (2002) etj. (Osman Ismaili)

TAHIRI Ramush (1954). Gazetar. Lindi në Ferizaj. Shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në Ferizaj, ndërsa Fakultetin e Shkencave Politike në Universitetin e Zagrebit. Punoi gazetar në të përditshmen “Rilindja” nga viti 1983 deri më 1991. Në fillim të viteve ’90 u përfshi në zhvillimet politike të asaj kohe, në kuadër të Partisë Shqiptare Demokratiane. Në vitet 1991-92 ishte zëvendëskryeministër i Qeverisë së Republikës së Kosovës në emigrim, ndërsa më vonë redaktor i botimit në Tiranë të gazetës “Rilindja” (1995-1999). Gjatë viteve 2000-2002 vazhdoi të punonte në gazetën “Rilindja”, ku shkroi analiza politike dhe shkrime të tjera publicistike. Në periudhën 2003-2006 ishte këshilltar politik i Kryetarit të Kuvendit të Kosovës, më pas drejtor politik për çështjet rajonale në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Kosovës dhe nga viti 2011 këshilltar politik i Presidentes së Kosovës deri në përfundim të mandatit. (Besim Abazi)

TAHIRSYLAJ Sylë (1949). Fizikan, meteorolog, profesor universiteti. Lindi në fshatin Isniq, ku kreu shkollën fillore, ndërsa Shkollën e Mesme Teknike, drejtimin e makinerisë, e kreu



SYLË TAHIRSYLAJ

në Prishtinë (1968). Studimet për fizikë i kreu në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore (FSHMN) të Universitetit të Prishtinës (UP) në vitin 1977. Studimet pasuniversitare i filloi në Fakultetin e Fizikës Teknike të Universitetit të Beogradit, por i përfundoi për fizikë në Fakultetin e Shkencave të Natyrës në Universitetin e Tiranës në vitin 1993. Tezën e doktoratës e mbrojti në të njëjtin universitet, nga fusha e fizikës së atmosferës - meteorologjisë (1996). Zgjidhet docent në Fakultetin e Bujqësisë të UP-së (1997). Ka qenë drejtor i Institutit Hidrometeorologjik të Kosovës (1999-2013), si dhe përfaqësues i parë nga Kosova në Organizatën Botërore të Meteorologjisë (WMO). Është autor dhe bashkautor i disa punimeve shkencore të botuara në botën e jashtme dhe në vend. Ka botuar tekste për shkolla të mesme. (Rexhep Gashi)

TAKIMET E POETESHAVE, VUSHTRRI. Manifestim letrar i femrave krijueseve, që tash mban emrin Festivali i poezisë “Takimet e Poeteshave Shqiptare”. Takimet kanë filluar të



TAKIMET E POETESHAVE, VUSHTRRI

mbahen për nder të Ditës Ndërkombëtare të Gruas, më 8 mars të vitit 1979. Në kuadër të këtij manifestimi janë mbajtur edhe tribunat letrare dhe diskutime për letërsinë dhe është dhënë çmimi për poezinë më të mirë të lexuar

në manifestim. Takimet janë mbajtur në vazhdimësi, me qëllim të nxitjes së krijimtarisë letrare të femrave kosovare dhe të afirmimit të femrave poete. Pas luftës së Kosovës (1999), kjo veprimtari mori emrin Festivali i poezisë “Takimet e Poeteshave Shqiptare” dhe në kuadër të tij shpallet konkursi për poezi të femrave poete nga mbarë hapësira shqiptare dhe diaspora. (Ragip Sylaj)

TAKIMET LETRARE “AZEM SHKRELI”, PEJË. Manifestim kulturor dhe letrar me seli në Pejë, i themeluar në vitin 2002, në nderim të poetit Azem Shkreli (1938-1997). Ka për qëllim të nxisë krijimtarinë letrare, promovimin e vlerave në ambientin kulturor të Pejës dhe në Kosovë. Në këtë veprimtari letrare, përveç tribunës letrare, orës letrare, jepen edhe çmime për vlerat e prezantuara në takime, përkatësisht çmimi “Takimet letrare A. Shkreli” dhe çmimi “Bulëzat”. Manifestimi organizohet nga drejtorja komunale për kulturë e komunës së Pejës, e mbështetur nga Ministria e Kulturës. Manifestimi mbahet në muajin maj. (Ragip Sylaj)

TAKVIMI-KALENDARI, PRISHTINË. Publikim vjetor islam, kalendar, revistë fetare dhe kulturore. U themelua në Prishtinë më 1970 nga Shoqata e Ulemave të Republikës së Serbisë. Është publikimi i parë islam në gjuhën shqipe, që jep kalendarin vjetor për kohët e namazit, agjërimin e Ramazanit dhe shënimin e festave islame për territorin e Kosovës. Takvimi në fillim të daljes së tij më tepër kishte karakterin e kalendarit islam, ndërsa me vonë, përveç këtij segmenti, rëndësi iu kushtua edhe botimit të artikujve për njohuritë bazike të fesë islame, me çka krijohet edhe pjesa tematike, në të cilin kanë kontribuar penat më të shquar të islamologjisë në Kosovë. Në dekadën e fundit, Takvimi, përveç temave fetare, ka ofruar për lexuesin edhe tema nga kultura, historia dhe trashëgimia. Autori i pjesës kalendarike që nga fillim i botimit e deri tash është Hajrullah efendi Hoxha. Takvimi është botimi më popullor dhe më i përhapur dhe me tirazhin më të madh në Kosovë. Deri më 1997 Takvimi është botuar nga Shoqata e Ulemave, ndërsa më pas është botuar nga Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës. (Hajrullah Hoxha)

TALJAVINI Karlo (Carlo Tagliavini) (1903-1982). Gjuhëtar italian, romanist, albanolog

e ballkanolog. Vijues i veprës albanologjike së Majerit (Meyer), Pedersenit dhe Joklit, Taljavini qe një personalitet i veçantë i shkencave gjuhësore. Ishte profesor në Universitetin e Padovës, ku mbajti për shumë vjet ligjërata të rregullta për gjuhën dhe letërsinë shqipe dhe, më 1936, themeloi katedrën e gjuhës dhe të letërsisë shqipe në këtë universitet. Botoi studime dhe artikuj për çështje të dialektologjisë, të leksikologjisë historike, të historisë së gjuhës shqipe dhe të gjuhësisë shqiptare. Shkroi vështrime të përgjithshme për shqipen në enciklopedi, përmbledhje e vepra të ndryshme. Dhe mbajti për disa vjet (nga 1941) rubrikën bibliografike për albanologjinë dhe ballkanistikën në publikimin “Indogermanisches Jahrbuch”. Me veprën “Shqipja e Dalmacisë” (L’albanese di Dalmazia, Firenze 1937) dha ndihmesë për njohjen e së folmes shqipe të Borgo Ericos (Arbneshit) afër Zarës. Në punimin “Shtresëzimi i leksikut të shqipes. Elementet indoeuropiane” (Stratificazione del lessico Albanese. Elementi indoeuropei, Bolonjë 1965), pjesë e kursit të tij universitar për gjuhën shqipe, dha ndihmesa edhe për studimet etimologjike në fushë të shqipes, duke vënë në dukje përfundimet e arritura në periudhën pas botimit të “Fjalorit etimologjik” të Gustav Majerit. Hartoi një monografi dialektologjike “Të folmet shqipe të tipit të gegërishtes lindore (Dardania dhe Maqedonia Veriperëndimore)” (Le parlate albanesi di tipo Ghego orientale (Dardania e Macedonia nord orientale), Romë, 1942), në të cilën dha edhe disa tipare të përgjithshme të të folmeve të Kosovës dhe të Maqedonisë. Veprimtaria shkencore romanisitike e K. Taljavinit është mjaft e gjerë, përfshin dhe “Gramatikë e rumanishtes” (Rumänisches Lesebuch, 1923), “Gramatikë elementare e gjuhës portugeze” (1938), “Dialekt i Livinallongo” (1942), “Elementet e fonetikës dhe morfologjisë historike të latinishtes” (1962.), “Hyrje në gjuhësi” (1969, 1970); “Panorama e historisë së gjuhësisë”; “Origjina e gjuhëve romane” (1972) etj. (Mensur Vokrrri)

TALOÇI Ludvig fon (Ludwig von Thallóczy) (1857-1916). Historian austro-hungarez, studiues i historisë së Ballkanit. Lindi në Koshice (Sllovakia e sotme). Kreu studimet për histori në Universitetin e Budapestit. Në vitin 1879 filloi punën në arkivin shtetëror të Hungarisë. U angazhua për studimin e historisë së Bosnjës dhe



LUDVIG FON
TALOÇI

Shuflajn dhe Konstandin Jireçekun shkruan dy vëllime të veprës “Aktet dhe diplomat që ilustrojnë ngjarjet në Shqipërinë mesjetare” (*Acta et diplomata Res Albaniae Mediae aetatis illustrantia*, Vjenë 1913, 1918). Supozohet se ai kishte dizajnuar stemën e Shqipërisë pas shpalljes së Pavarësisë. Talóçi kishte publikuar se mendimet rreth prejardhjes serbe të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut janë legjenda. Vdiq aksidentalisht me rastin e kthimit nga varrimi i perandorit Franc Jozefi I, kur ishte rrokullisur vagoni i trenit me të cilin udhëtonte. (Muhamet Mala)

TALLA Hyzri (1963-1998). Veprimtar, njëri nga udhëheqësit e luftës në Zonën e Llapit. Lindi në fshatin Letanc të komunës së Podujevës. Pasi kreu shkollën e mesme në Podujevë, në vitin 1983 u regjistrua në Fakultetin Teknik të Universitetit të Prishtinës. Më 1981 u anëtarësua në grupin ilegal “Kosova e re”, i cili shkruante parulla dhe botonte fletushkën “Përpjekja”. Më vonë u përfshi në strukturat ilegale të Lëvizjes Popullore të Kosovës (LPK) dhe nga viti 1995 në Lëvizjen Kombëtare për Çlirim dhe Kosovës (LKÇK). Ishte një nga bashkëpunëtorët e afërt të Fatmir Humollit. Gjatë viteve 1993-1995 disa herë udhëtoi në Shqipëri për furnizim me armë. U dallua në luftimet që u zhvilluan në Bardh të Madh dhe në Hade në verë të vitit 1998 dhe në Betejën e Kaçanollit. Kreu detyrën e zëvendëskomandantit të shërbimit të kundërbulimit në Zonën Operative të Llapit. U vra më 3 dhjetor 1998 në një pritë të organizuar nga forcat e sigurimit serb, në Lagjen “Kodra e Diellit” në Prishtinë, bashkë me Afrim Maliqin dhe Ilir Durmishin. Në vitin 2012 nga presidenti i Kosovës u dekorua me mirënjohjen “Urdhri i Lirisë”. (Ismet Cakiqi)

TANEFI Apostol (1916-1966). Mësues veteran. Lindi në Gllamboç, Prespë e Vogël, Shqipëri. Pas shkollës fillore kreu Normalen

e Elbasanit. Nga vitit 1935 punoi mësues i filloreve në Kavajë, në Vithkuq dhe në Korçë. Pas Luftës së Dytë Botërore vjen në Kosovë. Shërbeu si mësues në Gjilan, pastaj mësimdhënës në kurse pedagogjike. Në vitin shkollor 1946/47 gjendet me detyrë në Shkollën Normale të Gjakovës, si mësimdhënës i fizikës, matematikës dhe i gjeografisë. Nga viti 1949 ishte drejtor i gjimnazit të Pejës, ndërsa nga viti shkollor 1952/53 mësimdhënës i matematikës dhe i fizikës në gjimnazin e Prishtinës. U mor edhe me përkthimin dhe përshtatjen e teksteve shkollore nga këto lëndë. Ishte i përfshirë edhe në veprimtari politike në kuadër të Organizatës së Emigrantëve Shqiptarë në Jugosllavi. (Ali Llunji)

TANEFI-XHUFKA Lirie (1916-1999). Mësuese veterane. Lindi në Elbasan. Shkollën fillore dhe normalen i kreu në vendlindje. Nga viti 1935 ishte mësuese në shkollën fillore të Kavajës, pastaj në Vithkuq të Korçës, në Caredvor të Prespës së Madhe dhe në Pogradec. Më 1946 vjen në Kosovë dhe nis punën në Normalen e Gjakovës, së pari si mësuese e ushtrimores, pastaj mësimdhënëse e lëndëve të shkathtësisë. Nga viti shkollor 1949/50 ishte mësuese dhe drejtore e fillores dhe mësimdhënëse e gjuhës shqipe në gjimnazin e ulët në Pejë, ndërsa nga viti shkollor 1954/55 në gjimnazin e ulët në Prishtinë. Dy dekada do të shërbejë si mësimdhënëse e gjuhës shqipe në shkollën tetëvjeçare “Vuk Karaxhiq” në Prishtinë, ku edhe u pensionua. (Ali Llunji)

TANKOSIQI. Fshat në lindje të Ferizajit, rreth 12 km nga qendra, shtrihet përgjatë rrugës magjistrale Ferizaj-Gjilan, në lartësi mbidetare 560 m. Në vitet ‘20 të shekullit të kaluar këtu u vendosën 119 familje kolonësh serbë. Familjet e para shqiptare që fillojnë të blejnë pronën nga serbët vendosen në vitet ‘60 të shekullit të kaluar. Në vitin 1948 kishte 669 banorë, ndërsa sipas vlerësimeve të bëra në terren, në vitin 1999 në Tankosiq kanë jetuar rreth dy mijë banorë. Veprimtaritë kryesore ekonomike janë: lavërtaria, pemëtaria, perimtaria, tregtia etj. Ka shkollën 9-vjeçare, zyrën e vendit dhe disa njësi tregtare. (Shpend Agaj)

TANZIMATI. Periudhë e reformave për modernizimin e Perandorisë Osmane në shek. XIX. Meqë Perandoria Osmane kishte hum-

bur fuqinë, rolin dhe rëndësinë që kishte dikur nën trysinë e disa nga Fuqitë e Mëdha, u detyrua që të bënte reforma. Qëllimi i këtyre reformave ishte përshtatja e qeverisjes dhe e aparatit shtetëror me vendet e zhvilluara europiane. Këto reforma u zhvilluan në dy periudha: 1839-1856 dhe 1856-1876. Reformat synonin modernizimin e plotë të Perandorisë, por me dekret perandorak të shpallur në pallatin e Gjylhanesë (1839) u ndërmorën reforma të pjesshme të cilat konsistonin kryesisht në rimëkëmbjen e forcës ushtarake. Në kuadër të reformimit u bë i detyruar mobilizimi ushtarak pa shpërblim, si dhe centralizimi i pushtetit administrativ dhe financiar. Me reformat e Tanzimatit u keqësua edhe më tej gjendja e popujve të nënshtruar. Ato nuk sollën ndonjë përmirësim të gjendjes ekonomike, shoqërore e politike të shqiptarëve dhe të popujve të tjerë të robëruar. Reformat e Sulltan Abdyl Mexhitit nuk u njihnin shqiptarëve asnjë të drejtë. Përkundrazi, ato vendosën një shtypje të re administrative-ushtarake, veçmas duke vendosur shërbimin e rëndë ushtarak shumëvjeçar (deri në shtatë vjet). Arbitrariteti i funksionarëve të korrumpuar osmanë, favorët, ryshfetet, regjimi i dhunës, të gjitha këto keqësuan dhe më tepër gjendjen shoqërore dhe ekonomike. Organizimi politik i popujve të shtypur, i frymëzuar nga lëvizjet e tyre kombëtare, solli lëvizje të mëdha kryengritëse kundër reformave dhe Perandorisë Osmane në përgjithësi. (Teki Kurti)

TARABULLUZI Dom Mikel (1868-1933).

Prift dhe mësues atdhetar. Lindi në Prizren. Pasi kreu studimet për filozofi dhe teologji në Seminarin Papnor në Shkodër, shugurohet prift dhe shërben në disa famulli, në Pejë, në Prizren, në Shkup dhe në Letnicë. Më 1896 rihap shkollën shqipe në Stubëll, e cila u legalizua nga Austro-Hungaria më 1905. Mësimin në këtë shkollë e zhvillonte në gjuhën shqipe,



DOM MIKEL
TARABULLUZI

ndërsa konsullata austro-hungareze në Shkup e mbështeste financiarisht me tekste dhe me mjete të tjera mësimore. U përpoq për hapjen edhe të shkollave të tjera shqipe. Ishte bashkëluftëtar i Idriz Seferit. U përndoq nga autoritetet osmane dhe nga serbët. Burgoset tri

vjet. Është bartës i urdhrit “Mësues i Merituar i Kombit” dhënë nga Presidenca e Kosovës. Në respekt të veprës së tij mbahet edhe manifestimi i përvitshëm kulturor e letrar “Takimet e Dom Mikelit.” (Ali Lljunji)


TARAKU Ali (1932-1980). Volejbollist, trajner. Lindi në Pejë, ku edhe e filloi karrierën si volejbollist. Paraqitjet e para për “Buduqnostin” e Pejës i pati në vitin 1947, me të cilin luajti deri në vitin 1957. Më pas u shpërngul në Beograd, ku e vazhdoi karrierën sportive, duke luajtur për disa skuadra të këtij qyteti. Pas përfundimit të karrierës aktive, iu përkushtua punës së trajnerit dhe të gjyqtarit të volejbollit. Njëkohësisht mbajti edhe shumë funksione në organizatat e volejbollit në ish-Jugosllavi. U shqua sidomos si përzgjedhës i përfaqësueses së Jugosllavisë në konkurrencën e femrave. (Besim Kajtazi)

TARAKU Ekrem (1947-). Aktor. Lindi në Pejë. Kreu studimet në Shkollën e Lartë Pedagogjike dhe në Fakultetin Filozofik në Prishtinë. Pjesë e ansamblit të Teatrit Popullor Krahinor u bë në vitin 1971, ku interpretoi një sërë rolesh në shfaqjet: “Fosilet”, “Revizori”, “Dundo Maroje”, “Shtetrrethimi”, “Hotel kashta”, “Shfejku”, “Një nuse për Stasin”, “Besa e madhe”, “Raketat e bardha fluturojnë mbi Amsterdam”, “Trungu ilir”, “Hamleti”, “Verbimi i Samsonit”, “Confitëori”, “Mbikëqyrësi” etj. Emigroi në Amerikë që në fillim të viteteve ’90. Pos me aktrim është marrë edhe me karate. (Selman Jusufi)

TARAKU Nysret (1945-). Biolog, profesor universiteti. Lindi në Pejë. Shkollën fillore dhe atë të mesme i kreu në vendlindje, studimet universitare për biologji i mbaroi në Universitetin e Sarajevës (1972). Studimet pasuniversitare i kreu në Fakultetin e Shkencave Natyrore të Universitetit të Zagrebit dhe tezën e disertacionit të doktoratës e mbrojti po në këtë universitet (1980). Disa vite punon mësimdhënës i biologjisë në Shkollën e Mesme Bujqësore në Pejë, ndërsa më vonë në laboratorin e kombinatit agroindustrial gjithashtu në Pejë. Nga viti 1980 punoi në Institutin Bioteknik të Pejës, ku kreu edhe detyrën e drejtorit. Udhëhoqi projekte të ndryshme shkencore nga fusha e sëmundjeve virusale. Nga viti 2004 deri më 2007 ishte i angazhuar mësimdhënës në Fakultetin

e Edukimit të Universitetit të Prishtinës. Publikoi punime shkencore në fushën e virologjisë në vend e jashtë dhe monografinë “Viruset në bimët bishtajore (leguminozat) të Kosovës” dhe një pjesë të monografisë “Shkencat bujqësore të Kosovës”. Mori pjesë në konferenca dhe seminare brenda dhe jashtë vendit. (Fetah Halili)

TARAKU Selami (1951-). Regjisor, mësimdhënës universitar. Lindi në Pejë, ku kreu shkollimin fillor, ndërsa shkollën e mesme e mbaroi në Mitrovicë. Në Prishtinë kreu Shkollën e Lartë



SELAMI TARAKU

Pedagogjike, grupi e aktrimit, dhe më pas regjinë e filmit në Fakultetin e Arteve Dramatike në Universitetin e Beogradit (1981). Aktivitetin e tij si regjisor teatri e filloi në vitin 1985 me shfaqjet e Teatrit Popullor të Gjakovës “Babai im kullak socialist” dhe “Spiuni ballkanik” (1989). Në vitet ’90, në Teatrin Popullor Krahinor (TPK) u paraqit me shfaqjet “Nastasia Filipovna” (1993), “Garderobisti” (1996) dhe “Babai” (1997). Pas luftës, në vitin 2013, në Teatrin Kombëtar të Kosovës vuri në skenë shfaqjen “Dëshmitari”, ku ishte edhe autor i tekstit. Bëri edhe regjinë e disa filmave dokumentarë: “Kokani” (1980), “Bernardo Bertolucci” (1980) dhe i filmave të shkurtër “Signature” (1980), dhe “Rasti i Bogoljub Savkoviçit-shkrirësit” (1981). Mori një sërë çmimesh, ndër të cilët çmimi i jurisë për filmin e shkurtër më të mirë në Festivalin në Oberhausen të Gjermanisë (1981). Për filmat “Kokani” dhe “Rasti i Bogoljub Savkoviçit-shkrirësit” mori çmime edhe në festivlet prestigjioze të ish-Jugosllavisë. Është mësimdhënës i regjisë së filmit në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. (Besim Rexhaj)

TARIKATET. Rrugë apo metodë mistike që duhet ndjekur në besimin fetar islam. Pas profetit Muhamed, mistika islame ishte e organizuar në formë të grupeve të caktuara të asketëve dhe të shkollave mistike, mbështetur në ndonjërin nga parimet bazë të qasjes mistike ndaj botës dhe realitetit. Institucionalizimi i këtyre rrugëve mistike mori emrin tarikate. Në fillim tarikati kishte kuptimin e rrugës që duhej ndjekur për edukimin e shpirtit dhe

kontrollimin e shtytësve të unit dhe të karakterit njerëzor, ndërsa më vonë përfshiu tërësinë e rregullave dhe të parimeve etike dhe sociale të ndjekura nga ana e personave që marrin edukatë shpirtërore nën kontrollin e një shehu dhe brenda një teqeje të caktuar. Kjo qasje kryesisht u mor prej jetës së shokëve të profetit Muhamed. Për këtë arsye edhe zinxhiri i shehlerëve, që në tarikat është i domosdoshëm si person që udhëheq një institucion sufik, ka vazhduar në bazë të hallkës së parë në zinxhirin e tyre, të emërtuar si Bekrie ose Alie. Tarikatet si institucione të edukimit dhe arsimimit të hapur dhe të përgjithshëm kanë depërtuar në të gjitha poret e jetës shoqërore ku kanë vepruar, si rrjedhojë edhe në shoqërinë shqiptare. (Metin Izeti)

TARTARËT. Grup i popullsisë nga Azia Jugperëndimore, që sot banon në Republikën e Tataristanit dhe pjesë të tjera të Federatës Ruse. Pjesëtarë të pakicës tartare banojnë edhe në Ballkan, kryesisht në Bullgari dhe Rumani. Po ashtu shtrihen dhe në territorin e Krimesë, Kaukazit dhe deri në pjesë të ndryshme të Kinës. Pas depërtimit të fiseve mongole nën udhëheqjen e Xhingis Kanit në Europë, emërtimet mongol dhe tartar u përdorën si sinonime. Rrjedhimisht, tartarët shkretuan Poloninë dhe Hungarinë (1241), Kroacinë (1242) dhe sulmuan Rashën dhe Bullgarinë (gjysma e dytë e shek. XIII). Nuk është ruajtur ndonjë burim i shkruar dhe as nga trashëgimia materiale për sulmet e tyre në territorin e sotëm të Kosovës. Në kohën kur Perandoria Osmane zotëronte territoret e banuara me tartarë, ajo i përdori ata si kalorës dhe luftëtarë sulmues në ekspeditat pushtuese dhe ndëshkuese ndaj popujve të tjerë. Në Kosovë u përdorën si forca ndëshkuese nga ana e Perandorisë Osmane në luftërat austro-osmane (1689-1690). Nga sulmet e tyre kishin pësuar rëndë veçanërisht rrethinat e Prishtinës. Sipas burimeve të kohës, “në Kosovë shumë fshatra mbeten shkretë, shumicën e tyre i dogjën dhe i zhdukën osmanët dhe tartarët. Në mbarim të luftës austro-osmane trupat osmane dhe tartare hynë në Prishtinë dhe bënë ployë të madhe ndaj arbërve”. Tartarët i takojnë religjionit islam-suni, ndërsa një pakicë e tyre i përket krishterimit ortodoks. (Muhamet Mala)

TASIQ Nikolla (Nikola Tasić) (1932-). Arkeolog, akademik serb. Lindi në Beograd dhe

diplomoi në Fakultetin Filozofik të Beogradit (1954), ku dhe doktoroi më 1965. Punoi si kustos i Muzeut Popullor të Kragujevcit, prej nga kaloi në Muzeun Popullor të Zemunit, përkatësisht në Muzeun e Qytetit të Beogradit. Ishte pjesëmarrës në themelimin e Institutit Ballkanologjik të Akademisë Serbe të Shkencës dhe të Artit (SANU) dhe drejtor i tij (1989-2001), drejtor i Muzeut Kombëtar të Beogradit dhe sekretar i përgjithshëm i Akademisë Serbe të Shkencave dhe të Arteve. Është i njohur për gërmimet në Vinçë-Belo Bërdo, Gomolavë, gradinën e Bosutit, tumat e Përçevës në Kosovë etj. U zgjodh anëtar korrespondent i Akademisë Serbe në vitin 1988 dhe pastaj anëtar i rregullt (2000). Bibliografia e punimeve të tij përfshin arkeologjinë parahistorike dhe protohistorike, që nga neoliti e deri te ardhja e romakëve në Ballkan. (Sedat Barajliu)

TASHOLLI Faruk (1958-). Shkrimtar. Lindi në Gadime të komunës së Lipjanit. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, të mesmen në Ferizaj, ndërsa studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Prishtinës. Nga viti 1980 ishte gazetar dhe redaktor i kulturës në gazetën e studentëve “Bota e re”. Nga viti 1988 punoi në Radio-Prishtinë deri më 5 korrik 1990, kur forcat policore serbe e mbyllën me dhunë. Më 1994 emigroi në Gjermani, prej ku vazhdoi bashkëpunimin me programin satelitor të Radiotelevizionin Shqiptar në Tiranë, pastaj u angazhua në organet e shtypit shqiptar në emigracion. Aktualisht jeton në Ahen të Gjermanisë. Ka botuar dy libra me poezi për fëmijë: “Mos u rrit pa mua” (1978) dhe “Rosat mësojnë patinazh” (1990). Po ashtu është autor i dy librave me poezi për të rritur: “Drita të largëta” (1984) dhe “Tjerr fusharaku” (1988). Ka botuar dhe dy libra me portrete e reportazhe për mërgimtarët e suksesshëm në fushën e afarizmit në Gjermani: “Afaristë shqiptarë në Gjermani” (2008) dhe “Me tetovarët në Gjermani” (2009). (Shaip Beqiri)

TATIMET. Forma më e rëndësishme e të hyrave publike në shtetet bashkëkohore. Nëpërmjet tatimeve, si dhe me anën e taksave, kontributeve, huave publike dhe instrumenteve të tjera të të hyrave publike sigurohen mjetet e nevojshme për financimin e nevojave publike. Tatimet janë instrument i të hyrave publike, me

anë të të cilit shteti mbledh me detyrim mjetet në para, pa kundërshtim të drejtpërdrejtë, me qëllim të mbulimit të nevojave të veta financiare dhe arritjes së qëllimeve të tjera, në rend të parë atyre ekonomike dhe sociale, siç janë: mbrojtja e vendit, rendi dhe siguria, arsimit, shkenca, shëndetësia, kultura, transferet sociale. Të ardhurat nga tatimet shërbejnë si burim kryesor i të ardhurave për buxhetin e shtetit. Edhe në Kosovë tatimet mund të jenë të drejtpërdrejta, që u vihen personave fizikë dhe juridikë mbi bazën e të ardhurave apo pasurisë (tatimi mbi fitimin, mbi të ardhurat personale, mbi pronën) dhe të tërthorta, që janë tatime që mbledhen nga prodhimi ose konsumi i të mirave dhe shërbimeve ose nga transaksionet, si tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH), taksa doganore dhe akciza. Tatimet e kanë karakterin e instrumentit më të përshtatshëm të ndërhyrjes së shtetit jo vetëm në ekonomi, por edhe në shumë fusha të tjera të jetës shoqërore, duke mundësuar kështu arritjen jo vetëm të qëllimeve fiskale, por edhe të atyre ekstrasfiskale. Kosova karakterizohet në përgjithësi me ngarkesë të ulët tatimore, por edhe me probleme të grumbullimit të tyre qoftë për shkak të kapaciteteve të kufizuara të Administratës Tatimore, qoftë për shkak të nivelit të lartë të ekonomisë joformale. Rreth 70% e tatimeve në Kosovë mbledhen në kufi dhe kryesisht vijnë nga TVSH-ja dhe akciza e mallrave të importuara. (Drita Kongjeli)

TATIMI MBI FITIMET. Është tatimi mbi fitimet e korporatave. Tatimi mbi të ardhurat e korporatave është tatim që zbatohet mbi të ardhurat reale të korporatave. Ky tatim ka filluar të zbatohet në Kosovë që nga 1 prilli i vitit 2002. Aplikimi i këtij tatimi bazohet në Rregulloren nr. 2004/51 mbi tatimin mbi të ardhurat e korporatave në Kosovë, i cili ka hyrë në fuqi më 1 janar 2005. Prej 1 janarit 2009 ka hyrë në fuqi Ligji për tatimin mbi të ardhurat e korporatave, i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, që cakton normën tatimore prej 10% për çdo tatimpagues të regjistruar për tatimin në të ardhura të korporatave dhe i cili tatohet në bazë të të ardhurave reale. (Drita Kongjeli)

TATIMI MBI PAGAT. Tatim me të cilin ngarkohen punëdhënësit apo punëtorët, që llogaritet si përqindje e caktuar e pagës. Tatimi mbi paga ka filluar të zbatohet prej datës 1 prill 2002

mbi të ardhurat e tatueshme, që paraqesin të ardhurat bruto të të punësuarve për një periudhë të caktuar kohore. Këto të ardhura përfshijnë: rrogat, shpërblimet, bonuset, komisionet dhe çdo formë tjetër pagimi në lidhje me punësimin. Nga 1 janari 2005 ka hyrë në fuqi edhe Rregullorja nr. 2004/52 mbi tatimin e të ardhurave personale. Tatimi mbi të ardhurat personale është tatim gjithëpërfshirës mbi të ardhurat në Kosovë dhe me të ngarkohen të ardhurat nga të gjitha burimet e jo vetëm të ardhurat nga pagat. Tatimi mbi pagat është vetëm një element i tatimit në të ardhurat personale. Ky lloj i tatimit zbatohet mbi të ardhurat bruto nga pagat, aktivitetet afariste, qiratë, shfrytëzimi i patundshmërive, interesi, dividendi, pensionet, lotaritë dhe lojërat e tjera të fatit. Tatimi mbi paga fillon nga 0 e deri në 10%, varësisht nga lartësia e pagës. (Drita Kongjeli)

TATIMI MBI PRONËN. Një obligim që pronari duhet t'ia paguajë komunës për pronën që posedon. Tatimi mbi pronën është në përgjegjësi të plotë të pushtetit lokal dhe është burim i rëndësishëm i të hyrave vetanake të komunave. Paraqet një hap konkret për zgjerimin e bazës tatimore dhe për decentralizimin fiskal. Norma e tatimit përcaktohet nga vetë komunat, por ajo nuk duhet të kalojë 2% të bazës së tatueshme. Baza e tatueshme përcaktohet në bazë të vlerës së tregut të pronës së paluajtshme. Të hyrat nga tatimi mbi pronën komuna i shfrytëzon për zhvillimin e infrastrukturës me qëllim të përmirësimit të jetës së qytetarëve. (Drita Kongjeli)

TATIMI MBI VLERËN E SHTUAR (TVSH). Tatim shumëstresor mbi konsumin, që mbledhet mbi një gamë të gjerë të mallrave dhe shërbimeve. Paguhet në çdo fazë të prodhimit dhe qarkullimit, përfshirë këtu edhe konsumin final, por paguhet vetëm mbi vlerën e shtuar në çdo fazë. TVSH-ja është proporcionale me çmimin e mallrave dhe shërbimeve, ngarkohet në faza të ndryshme të prodhimit, shpërndarjes dhe shitjes së produkteve dhe shërbimeve dhe në fund i ngarkohet konsumatorit. Me ligj përcaktohet pragu i qarkullimit për firmat që obligohen të aplikojnë tatimin mbi vlerën e shtuar. TVSH-ja në Kosovë ka dy nivele të shkallëzuara: 8% për disa produkte me ndikim në standardin e jetës dhe 18% për produktet dhe shërbimet e tjera. (Drita Kongjeli)

TEATRI "DODONA". Është teatër i qytetit të Prishtinës. U themelua si Teatër i të Rinjve, Fëmijëve dhe Kukullave më 12 nëntor 1986 nga Kuvendi Komunal i Prishtinës. Punën krijuese



SHFAQJE E TEATRIT "DODONA"

me aktorët, përmes shfaqjeve me kukulla dhe shfaqjeve për fëmijë, fillimisht e drejtoi regjisorin kroat, Borisllav Mërkshiq, ndërkaq prej vitit 1988 e këndeje e vazhdoi regjisorja Melihate Qena. Shfaqja e parë për fëmijë e këtij teatri ishte "Pylli është i të gjithëve" (1987) sipas tekstit të Shaip Grabovcit, në regji të Borisllav Mërkshiqit. Asokohe shfaqjet e këtij teatri jepeshin në amfiteatrin e Pallatit të Rinisë dhe, herë pas here, edhe në skenën e Teatrit Popullor Krahinor në Prishtinë. Më 1992, përkatësisht pas ndërtimit të godinës në lagjen "Kasallarët", ky teatër u pagëzua me emrin Teatri "Dodona". Në vitet 1991-1994 drejtor ishte aktori Enver Petrovci. Repertori i këtij teatri identifikohet me skenën e paradites, në të cilën jepeshin shfaqjet me kukulla dhe shfaqjet për fëmijë, si dhe me skenën e mbrëmjes, në të cilën jepeshin shfaqjet për të rinj dhe për të rritur. Shfaqja "Picrraku" (1992), sipas tekstit të Karel Novakut dhe me regji nga Melihate Qena ishte premiera e parë për fëmijë në skenën e paradites. Skena e mbrëmjes u promovua me komedinë "Profesor, jam talent se jo mahi", e cila si shfaqje ishte krijuar më herët. Premiera e parë e kësaj skene ishte shfaqja "Tregimi zoologjik" sipas tekstit të Edward Albeet dhe me regji të Faruk Begollit. Më 1994 në këtë teatër u vendos administrimi i dhunshëm serb. Edhe pse u aplikuan masa të dhunshme, skena e mbrëmjes funksiononte kryesisht përmes shfaqjeve të krijuara nga kompania private FTD (Film, Teatër, Dizajn), të cilën e drejtonte aktori Faruk Begolli, si dhe përmes shfaqjeve të studentëve të aktrimit

dhe të regjisë së teatrit të Fakultetit të Arteve të Universitetit të Prishtinës. Krahas disa komedive të lehta, aty gjatë kësaj kohe u krijuan edhe shfaqjet: "Ditë vere", "Kufiri me atdheun", "Dante 9", "7 ngjyra, lamtumirë", "Këngëtarja tullace", "Dashuritë e Xhorxh Uashingtonit", "Katër epoletat", "Audienca", "Karriget" etj. Asokohe shfaqja "Duke pritur Godonë" (1996) e këtij teatri, me regji të Fadil Hysajt, u nderua me çmimin special të jurisë në Festivalin Ndërkombëtar të Teatrit MESS, në Sarajevë. Pas mbarimit të luftës (1999), përveç shfaqjeve të shumta për fëmijë dhe me kukulla, ky teatër vazhdoi traditën e inskenimit të komedive të lehta, por gjithashtu edhe të disa shfaqjeve me cilësi artistike. Gjatë kësaj kohe, në këtë teatër u krijuan shfaqja "Mësimi" (2002), sipas tekstit të Eugen Joneskos dhe me regji të Bekim Lumit, e cila në Festivalin Ndërkombëtar të Teatrit (2006) në Lugano (Zvicër) mori çmimin si shfaqja më e mirë. Në këtë kohë u krijuan edhe shfaqja "Menaxheria e qelqtë" (2002) sipas tekstit të Tenesi Uilliamsit dhe me regji të Ilir Bokshit. Disa nga shfaqjet me kukulla të këtij teatri ("Qeni që nuk dinte të lehtë", "Elefanti i vogël kureshtar", "Princeshat dhe dragoi" etj.), të realizuara nga regjisorja Melihate Qena, janë nderuar me çmime të shumta në edicionet e ndryshme të Festivalit të Teatrove të Kukullave "Xinxifillo" në Pogradec (Shqipëri). (Bekim Lumi)

TEATRI "ODA". Është teatër i pavarur me seli në Prishtinë, i cili u themelua në vitin 2002, me nismën e Lirak Çelajt, aktor dhe Florent Mehmetit, regjisor. Premiera e parë "Monologët



NJË SHFAQJE E TEATRIT "ODA"

e vagjinës" u dha më 1 mars 2003. Në këtë teatër gjatë viteve në vijim janë dhënë dhjetëra

premiera shfaqjesh dhe performancash teatrore të zhanreve dhe të qasjeve të ndryshme. Teatri “Oda” njihet për produksione teatrore të një natyre jokonvencionale. Përveç produksionit të vet, ka realizuar edhe bashkëpunime dhe bashkëprodhime me teatro dhe trupa të tjera teatrore nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia dhe rajoni e më gjerë. Teatri “Oda” është anëtar i rregullt i rrjetit më të madh të teatrove në Europë, “Informal European Theatre Meeting-IETM” dhe anëtar i rrjetit “Ballkan Express” (rrjet i teatrove të rajonit të Ballkanit). Në kuadër të këtij teatri funksionon edhe programi “Oda për të rinj”, që u jep mundësi të rinjve të marrin pjesë në projekte artistike teatrore të mbikëqyruar nga profesionistët. Teatri “Oda” është nismëtar dhe themelues i Forumit Kulturor të Kosovës, që është konceptuar si rrjet i organizatave të pavarura kulturore. (Arian Krasniqi)

TEATRI I FERIZAJT. Institucion teatror i qytetit të Ferizajt, i themeluar në vitin 1946, si grup dramatik në kuadër të Shoqërisë Kulturore Artistike “Mustaf Bakija”. Në të vërtetë, që më



TEATRI I FERIZAJT

1941, me nismë të Lorenc Antonit, në kuadër të aktiviteteve kulturore të qytetit nisin të luhen edhe shfaqje amatore. Më pas aktiviteti teatror intensifikohet dhe në shfaqjet e inskenuara marrin pjesë edhe aktorët: Katarina Josipi, Shaban Gashi, Matej Serreçi etj. Në vitet ‘70, Teatri i Ferizajt mori emrin “Vëllezërit Frashëri” dhe po në këtë kohë u themelua edhe festivali i teatrove amatore të Kosovës, më vonë festivali kryesor i teatrove në Kosovë. Në vitet ‘50 dhe ‘60 shumicën e shfaqjeve i vendosi në skenë aktori dhe regjisori Matej Serreçi. Më pas, nga fundi i viteve ‘70 dhe në vitet ‘80 në

këtë teatër u realizuan shfaqje nga regjisorët: Fadil Hysaj, Atdhe Gashi, Ismail Rama, Agim Sopi, Fatmir Hyseni etj. Që nga viti 1999, Teatri mban emrin e aktore “Adriana Abdullahu”. Në vitin 2007, me vendim të Ministrisë së Kulturës të Republikës së Kosovës, Teatri i Ferizajt mori statusin e teatrit profesionist. (Arian Krasniqi)

TEATRI I GJAKOVËS. Institucion teatror i qytetit të Gjakovës, i themeluar në vitin 1976. Themelimit të këtij teatri i parapriu një traditë relativisht e gjatë e jetës teatrore në shoqëritë



NJË SHFAQJE E TEATRIT TË GJAKOVËS

amatore të qytetit. Në vitin 1954 në Gjakovë u themelua teatri amator “Emin Duraku”, i cili me punën intensive, me numrin e premierave dhe reprizave u shndërrua pothuajse në teatër profesionist. Brenda një periudhe prej dy dekadash, Teatri “Emin Duraku” realizoi 75 premiera me 325 repriza. Aktiviteti i frytshëm i këtij teatri rezultoi me themelimin e teatrit profesionist të Gjakovës, i cili u bë në vitin 1976. Premiera përuruese ishte shfaqja “Fisheku në pajë” (1977) e F. Krajës, në regjinë e M. Qenës. Në dhjetëvjetëshin e parë të jetës profesionale, pjesën më të madhe të repertorit e zunë autorët botërorë dhe ata jugosllavë, midis tyre: Zh. P. Sartër me dramën “Të vdekur të pavarrosur” (1978) në regji të A. Kovaçeviqit, ndërsa pasuan A. Strindbergu me dramën “Babai” (1978), Moliere me dramën “I sëmuri për mend” (1980) në regji të A. Gashit dhe “Tartufi” (1984) në regji të B. Sahatçiu etj. Teatri i Gjakovës, krahas dramaturgjisë botërore vuri në skenë edhe veprat e autorëve shqiptarë, si “Epoka para gjyqit” e E. Kryeziut (1978), “Pirrua” e Y. Shkreliut në regji të A. Sopot (1983), “Unë, Halil Garria” e B. Musliut (1983), “Beselam, pse më flijojnë” (1985) e R. Qosjes dhe “Hëna prej

letre” e M. Krajës (1988) në regji të F. Hysajt, “Rënia e madhe” e J. Buxhovit në regji të I. Ymerit (1986), “Më ndihmo, Naze” me tekst e regji të A. Gashit (1987) etj. Nga aktorët e shquar të trupës që kanë pasur një karrierë të suksesshme dhe me shumë role të mirëpritura prej publikut veçohen H. Shehu, J. Shehu, B. Muçaj, M. Kurtishi, G. Jetishi, N. Muçaj, R. Berkani, S. Lokaj, M. Murriqi, H. Binaku etj. Nga regjisorët që kanë dhënë ndihmesë në zhvillimin dhe përtëritjen e teatrit kanë qenë M. Qena, A. Gashi, F. Hysaj, A. Kovaçeviq, F. Mehmeti etj. Që nga vitit 2000 e deri më sot, me gjithë vështirësitë e shumta financiare dhe organizative, Tetari i Gjakovës ka arritur të realizojë vepra të zhanreve të ndryshme të dramaturgjisë, me një produksion teatror prej 4-5 premierash në vit. Njëri nga dramaturgët të vënë në skenën e këtij teatri gjatë kësaj periudhe është H. Mulliqi me veprat: “Si e mposhta Musolinin”, në regji të A. Selimit (2001) dhe “Kaos atdhedashurie në Paris”, në regji të S. Tarakut (2004). Në regji të vetë autorit A. Mulliqi janë inskenuar shfaqjet: “Parfumeria” (2002), “Gjakova një luftë ndryshe” (2003), “Kosowars” (2005) etj. Gjatë kësaj periudhe në këtë teatër kanë filluar të angazhohen edhe regjisorë nga Shqipëria si: S. Fanko, M. Kutali, G. Kame dhe regjisorë të brezit të ri, si I. Bokshi, Z. Hoxha-Krasniqi etj. Teatri i Gjakovës është i dyti për nga rëndësia që ka statusin e teatrit publik në nivel vendi. (Besim Rexhaj)

TEATRI I GJILANIT. Është teatër i qytetit të Gjilanit, i cili zhvillon veprimtari teatrorë që nga vitet '40 të shekullit të kaluar. Ka filluar në seksionin i dramës të Shoqërisë kulturore-artistike “Drita” më 1944, kur shfaqjet e para krijoheshin nga artistët entuziastë amatorë. Në fillim të viteve '70, me ardhjen e Muharrem Shahiqit nga Teatri i Kombësive në Shkup, si dhe me angazhimin profesional të Fetah Mehmetit e më pas të Nuhi Matoshit, Jahi Jahiut, Ruzhdi Mehmetit etj., u vunë themelet e teatrit profesionist. Shfaqja “Gjenerali i ushtrisë së vdekur” (1976) në regji të Fetah Mehmetit ishte shfaqja e parë profesioniste e këtij teatri. Që atëherë ky teatër me shfaqjet e tij mori pjesë në festivale të ndryshme teatrorë në Kosovë dhe në ish-Jugosllavi, në të cilat u nderua me çmime të ndryshme. Disa nga shfaqjet me të cilat identifikoheshin ky teatër në vitet 1970-1990 janë: “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”,



TEATRI I GJILANIT

“Princi i hijeve”, “Certifikata e kurorëzimit”, “Rropullari”, “Familja e shenjtë”, “Drenusha”, “Monserati”, “Hamleti në livriçkën e poshtme”, “Në agoni”, “Kush nuk vdes nuk është njeri”, “Banesa e përbashkët” etj. Në fillim të viteve '90 në këtë teatër u vendos administrimi i dhunshëm i Serbisë. Gjatë kësaj kohe e deri në vitin 1999, shfaqjet e këtij teatri, si: “Froni”, “Kufij që preken”, “Një natë në hotel”, “Vdekja e një mbretëreshë” etj., u dhanë në objektin e Shtëpisë së Kulturës në Përlepnice të Gjilanit. Më 1991 Teatri i Gjilanit themeloi Festivalin e dramës kombëtare “Talia e Flakës”. Në vitet e pasluftës, prej 1999 e këndeje në këtë teatër u krijuan shfaqjet: “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”, “Miza në vesh”, “Anonimi i Venedikut”, “Romeo e Zhuljeta”, “Kumbara”, “Mos e prek”, “Darka publike”, “Vegullia”, “Sakati nga Inishmani”, “Seks, rrena dhe pata t’egra”, “UN Inspektori”, “Rekuem”, “Mbledhje në parlament” etj. Disa nga shfaqjet e këtij teatri u nderuan me çmime të ndryshme në festivalet teatrorë kombëtare. (Erson Zymberi)

TEATRI I MITROVICËS. Institucion teatror i qytetit të Mitrovicës, i themeluar në vitin 1953, ku u iniciua formimi i grupit të aktorëve amatorë të qytetit të Mitrovicës. Për shumë vjet statusi i këtij teatri nuk mori një zgjidhje, duke u luhatur gjithnjë midis tetarit amator dhe profesionist. Edhe pse në rrethana të tilla, në punën e këtij teatri herë pas here u përfshinë profesionistë, aktorë dhe regjisorë, të cilët e ngritën cilësinë e punës artistike në nivel më të lartë. Ndonëse nuk kishte një ansambël rezident, në Teatrin e Mitrovicës dhanë kontributin e tyre aktorë dhe regjisorë të njohur të artit skenik në Kosovë, si: Naxhije Deva, Xhevdet Lila, Muharrem Qena, Melihate Qena, Hyrije Hana, Xhevdet Terziu

etj. Në vitin 2011, teatrit të këtij qyteti i njihet statusi i teatrit profesionist. Nga ky vit e prapa numri i premierave të realizuara shënoi rritje të vazhdueshme. (Arian Krasniqi)

TEATRI I PEJËS. Institucion teator i qytetit të Pejës, i themeluar si teatër profesionist në vitin 2007. Po me këtë rast, teatri mori emrin e aktorit të njohur Istref Begolli. Themelimit të



TEATRI I PEJËS

këtij teatri i ka paraprirë një traditë paraprake teatrore në këtë qytet, që daton qysh prej para disa dekadash. Që në vitet '50-'60 të shekullit të kaluar, Teatri i Pejës kishte në përbërje aktorë të njohur dhe bënte shfaqje cilësore. Shfaqjet më të vizituara atëbotë ishin komeditë "Dredhitë e Shaptukut" dhe "Burri burrë", me rolet e interpretuara nga Kristë Berisha, Ilijaz Nushi, Sytkie Turjaka, Nazmije Thaçi etj. Gjithashtu duhet përmendur edhe drama e Jusuf Kelmendit "Hakmarrja, e cila u prit mirë nga publiku, për shkak të temës që trajtonte. Në periudhën e pasluftës 1999-2003 në Teatrin e Pejës nuk u zhvillua aktivitet artistik, sepse objektin e teatrit e përdorën forcat e KFOR-it për nevojat e veta. Në të vërtetë ngecja e jetës teatrore në Pejë zgjati deri në vitin 2001, kur u aftësua objekti i Kino-teatrit "Jusuf Gërvalla", i cili deri në lirimin e teatrit të qytetit (26 prill 2003) shërbeu për aktivitete të ndryshme kulturore. Me rihapjen e objektit të teatrit filluan edhe përpjekjet e komunitetit artistik të Pejës për ta bërë teatrin e qytetit të Pejës teatër profesionist. Që nga shfaqja "Narkomanët", me tekst të Reshat Nurbojës dhe regji të Ruzhdi Spahiut (2008), Teatri i Pejës arriti të realizonte 27 premiera, ndërsa me shfaqjet e veta mori pjesë në festivalet e ndryshme në Kosovë (Ferizaj, Gjilan dhe Podujevë), në Maqedoni

(Dibër, Kumanovë), në Shqipëri (Tiranë, Fier) dhe në vendet e tjera të rajonit. (Ragip Sylaj)

TEATRI I PRIZRENIT. Institucion teator i qytetit të Prizrenit, i themeluar si teatër profesionist me një vendim të nxjerrë nga Asambleja Komunale e Prizrenit më 28 prill 2005, ndërsa statuti i teatrit u nxor në dhjetor të vitit 2007. Në po këtë vit filloi me projektin e parë teator me shfaqjen "Im atë donte Adolfin", dramatikim i romanit homonim i shkrimtarit Mehmet Kraja dhe në regji të Agim Sopit. Fillet e historikut të Teatrit të Prizrenit i hasim që në vitin 1890, me një pjesë liturgjike të përgatitur nga mësuesi Mati Logoreci. Në vitin 1935 u shfaq pjesa "Makaronat e shejtanit" të autorit Lazër Lumezi, i cili e bëri edhe regjinë e pjesës. Në vitet 1946-1948 në Prizren nisi punën Teatri Popullor Krahinor, pastaj vazhdoi punën në Prishtinë, ku u zhvendos kryeqendra administrative e atëhershme e Kosovës. Aktorët e parë të teatrit profesionist në Prizren kanë qenë: Kristë Berisha, Gjon Oroshi-Kola, Shaban Domi, Kolë Bitër Shiroka, Qamil Nixha, Shefqet Tafarshiku, Simon Krasniqi, Gjon Marku, Hyda Leskovçaliu, Shefqet Musliu etj. Kah fundi i vitit 1950 Këshilli Popullor i Prizrenit miratoi vendimin për themelimin e teatrit amator të qytetit. Në fillim të viteve '70 në Prizren, për dy sezona funksionoi teatri gjysmëprofesionist, ku kanë punuar tre-katër aktorë profesionistë. Teatri i Prizrenit që nga viti 2007 ka realizuar një sërë premierash. (Ragip Sylaj)

TEATRI KOMBËTAR I KOSOVËS. Institucioni kryesor i artit skenik në Kosovë. Si Teatër Popullor Krahinor i Kosovës u themelua në shtator të vitit 1945, në Prizren, me ansambël aktorësh amatorë, të përzgjedhur nëpër qytete të ndryshme të Kosovës. Shfaqja e parë e realizuar në këtë teatër ishte "Flamuri dhe nana", një fragment nga romani "Nëna" e Maksim Gorkit e dramaturgizuar nga Tajar Hatipi në regji të Pavle Vugrinacit. Promovimi zyrtar i Teatrit Popullor Krahinor u bë më 7 qershor të vitit 1949, me shfaqjen "Personi i dyshimtë" të Branislav Nushiçit, në regji të Dobrica Radenkoviçit në Shtëpinë e Kulturës në Prishtinë, e cila që nga viti 1948 u bë godinë e Teatrit. Në këtë teatër u themeluan ansambli i dramës shqiptare dhe i dramës serbe, të cilëve në vitet '70 iu shtua edhe ansambli i baletit. Teksti i parë i inskenuar



TEATRI KOMBËTAR I KOSOVËS

nga dramaturgjia shqiptare ishte “Besa” e Sami Frashërit, premiera e së cilës u mbajt gjatë sezonit 1950/ 51. Pastaj u inskenuan edhe drama të tjera si “Nuk martohem me parë” dhe “Parajsa”, të Murteza Pezës, “Kryet e hudrës” të Kristë Berishës etj. Pas një përzgjedhjeje të aktorëve të talentuar nëpër shoqëritë amatore të qyteteve të Kosovës, drejtori i Teatrit, Millutin Jasniqi, arriti të kompletojë ansamblin e dramës shqiptare, duke sjellë nga qytete të ndryshme të Kosovës aktorët Shani Pallaska, Shaban Domi, Abdurrahman Shala, Meribane Shala, Muharrem Qena, Katarina Josipi, Matej Serreçi, ndërsa me pas angazhoi Xhevat Qenën dhe Melihate Ajetin. Nga viti 1951 deri në vitin 1965 (në kuadër të 15 sezoneve teatrore) u dhanë 76 premiera, shumica prej tyre nga dramaturgjia jugosllave dhe botërore, të cilat u realizuan nga regjisorët si Boshka Pishtallo, Sllavolub Stefanoviq-Ravasi dhe Abdurrahman Shala. Pas Plenumit të Brioneve (1966), në krye të TPK-së ershi shkrimtari Azem Shkreli, kur, pos tjerash, u inskenua edhe drama “Erveheja” e Ahmet Qirezit në regjinë e Muharrem Qenës, e cila pas suksesit në Festivalin e Sterjes në Novi-Sad (çmimi për regji, 1972) u bë shfaqja kult e Teatrit të Kosovës, duke bërë që ky teatër të dalë nga anonimiteti. TPK-ja më pas realizoi shfaqjet “Duke pritur Godonë” të Samuel Beketit në regjinë e Ljubomir Millosheviqit (1970), pastaj “Makbethin” e Shekspirit në regji të Georgi Paros, “Gjenerali i ushtrisë së vdekur” sipas romanit të Ismail Kadaresë në regji të Piro Manit, “Golgota” e Miroslav Kërlezhës, “Sfinga e gjallë” e Rexhep Qosjes (1976) në regji të Ljubisha Georgijevskit etj. Ky aktivitet i frytshëm teatror bëri që drama shqipe e Teatrit të Kosovës të arrijë afirmim të plotë në përmasa jugosllave. Me shumicën e këtyre

shfaqjeve, trupa e kësaj drame mori pjesë në takimet teatrore “Joakim Vujiq” në qytete të ndryshme të Sërbisë, prej ku vazhdimisht u kthye me çmimet kryesore. Pati depërtime të suksesshme edhe në festivale të tjera, si në Festivalin e Skenave të Vogla e Eksperimentale MESS të Sarajevës, në Lojërat e Sterjes të Novi-Sadit dhe Lojërat Verore të Dubrovnikut. Kjo e bëri Teatrin Kombëtar të Kosovës njërin nga teatrot më prestigjioze në ish-Jugosllavi.

Ndërkaq, gjatë viteve tetëdhjetë (nën udhëheqjen e Hazir Myfarit) në Teatrin Popullor të Kosovës do të dominojnë shfaqje me një poetikë regjisoriale estetifikisht autentike. Shfaqjet “Trungu Ilir” (sipas poezisë së Sabri Hamitit), “Gjërat që s’preken” (sipas poezisë së Rrahman Dedajt), “Shënimet e Gjon Nikollë Kazazit” të Jusuf Buxhovit (1983), “Princi i hijeve” të Mehmet Krajës dhe shfaqje të tjera në regji të Agim Sopit, pastaj “Ifigjenia ne Aulidë” e Euripidit (1983) dhe “Vdekja më vjen prej syve të tillë” (1988) sipas romanit të R. Qosjes në regji të Fadil Hysajt, sikundër edhe shfaqjet “Bregu i pikëllimit” (1986) i Teki Dërvshit, “Dervishi dhe vdekja” e Mesha Selimoviqit, “Confiteori” të Borisllav Shnajderit, që të gjitha në regji të Vladimir Milçinit (1985) sollën një frymë bashkëkohore në skenën e TPK-së dhe krijuan edhe një profil identitar të kësaj skene, ku kultivohej një teatër me figuracion të pasur skenik, që e sfidonte ideologjinë e kohës. Kjo bëri që një pjesë e këtyre shfaqjeve të hiqen shpejt nga repertori. Vitet nëntëdhjetë ishin vitet e agonisë së TPK-së. Nën tryshninë e masave të dhunshme të administratës së Serbisë, ansambli shqiptar nisi të shkapërderdhej dhe të degradojë artistikisht, duke humbur edhe spektatorin. Gjatë kësaj kohe u punuan shfaqjet “Gof” e Anton Pashkut në regji të Xhevat Qorrjat (1994), “Garderobisti” i R. Hardvudit (1995) si dhe “Babai” i Strinbergut (1997) në regji të Selami Tarakut, me çka pak a shumë u ruajt vazhdimësia e dramës shqiptare.

Në vitet e pasluftës TPK-ja u shndërrua në Tetarin Kombëtar të Kosovës, por sfidë kryesore e tij ishte kthimi i spektatorit. Gjatë kësaj periudhe ndërruan jetë një pas një aktorët dhe regjisorët më të mirë të Kosovës: Abdurrahman Shala, Shani Pallsaka, Avdush Hasani, Istref Begolli, Melihate Ajeti, Muharrem Qena, Besim Sahatçiu. Ndërkohë, në skenën e këtij teatri po bënin emër një brez i ri aktorësh me individualitet krijues. Kështu, në dekadën e parë



SKENË NGA SHFAQJA "ERVEHEJA"

të pasluftës në Teatrin Kombëtar (të udhëhequr nga aktor i ri Lirak Çelaj e pastaj nga Teki Drevishi dhe së fundi nga Arian Krasniqi dhe Agim Sopi) u inskenuan shfaqje nga autorë dhe regjisorë të ndryshëm. U inskenuan "Hamleti" i Shekspir në regji të Dejvid Gothardit dhe Fatos Berishës (1999), "Fluturimi mbi folenë e qyqes" në regjinë e Ilir Bokshit (2000), "Shfaqja e fundit" në regji të autorit Fadil Hysaj, "Pallati i ëndrrave" i Ismail Kadare në regji të Altin Bashës (2002), "Ku është populli" i Teki Dervishit në regji të Esat Brajshorit, pastaj shfaqjet: "Orestija" (2003), "Mbreti Lir" (2005), "Hana prej letre" (2008), "Bodrumi", "Shtëpia në ankand", "Kutia e zezë", "Arushani dhe fejesa" (2005) etj. U inskenuan edhe shfaqje të tjera, nga regjisorë të rinj, si Fatos Berisha, Iliriana Arifi, Kushtrim Koliqi etj., por mungesa e ansambllit rezident bëri që shumica e shfaqjeve të jetonin në skenë vetëm një sezon teatror, gjë që e dëmtoi ndjeshëm repertorin e Teatrit Kombëtar të Prishtinës. (Fadil Hysaj)

TEATRI LABORATOR "LOJA". Teatër i pavarur eksperimental. U themelua në vitin 2009 në Prishtinë nga regjisori Bekim Lumi. Ky teatër në rrafshin estetik u identifikua me idetë, frymën, konceptet, format dhe shprehjet artistike me karakter eksperimental e minimalist. Disa nga veçoritë e këtij teatri janë: trajnimi i gjithanshëm artistik e profesional i aktorëve, leximi, dekodimi, përshtatja, interpretimi dhe orkestrimi skenik i tekstit përmes gjuhës së shenjave, shfrytëzimi i mundësive të shumta të gjuhës së trupit dhe i teknikave të ndryshme të zërit, si dhe përshtatja dhe shfrytëzimi i rekuizitave, i instrumenteve muzikore dhe i hapësirës skenike në kontekstin performativ. Shfaqjet e këtij teatri, si "Këmisha e gjakut" (2010), "Di-

lerat" (2013) dhe "John Cage's Hamlet" (2015) janë krijuar në hapësira të ndryshme alternative, të tilla si: Muzeu Etnologjik, Shtypshkronja "Rilindja" dhe "Modelariumi" i Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës. Ky teatër, me shfaqjet e tij, mori pjesë në disa festivale teatrorë ndërkombëtare, në të cilat u vlerësua me çmime të ndryshme. (Besim Rexhaj)

TEATROT PRIVATE. Institucione të pavarura teatrore, që kultivojnë dhe përhapin vlerat e artit skenik në Kosovë. U themeluan kryesisht pas përfundimit të luftës së vitit 1999. Teatri i parë i pavarur në Kosovë është Teatri "Oda", me seli në Prishtinë. Më 2003 ky teatër realizoi premierën e parë "Monologët e vagjinës" dhe deri në vitet në vazhdim prodhoi mbi 35 shfaqje të autorëve shqiptarë dhe të huaj. Ndërkohë, Shoqata për Kultivimin e Artit Skenik e Filmik "Sythi", që është pasardhëse e trupës teatrore me të njëjtin emër, ka realizuar më se 15 projekte skenike teatrore dhe ka botuar disa numra të revistës për dramë dhe teatër "Theatri" (1995-2000), pastaj ka organizuar "Lojërat e vjetra teatrore" (2001) dhe aktivitetin teatror "Akademia mobile" në Mitrovicë, Ferizaj dhe Prizren (2002-2003). Prej vitit 2011 Shoqata "Sythi" organizon Festivalin e Arteve dhe Kulturës Tradicionale "Etno Fest" në fshatin Kukaj në Prishtinë. Shtëpia Teatrorë Filmike "Akt" u themelua si vazhdimësi e Teatrit Epik, i cili qe themeluar në vitin 1994 dhe funksionoi si teatër shëtitës profesional deri më 1997. Realizoi 35 shfaqje teatrore, filma artistikë televizivë dhe radiodrama. Në kuadër të kësaj shtëpie u themelua grupi "Aktorët e rinj - Studio Akt", i cili realizoi disa performanca për fëmijë. Deri më tash kjo shtëpi teatrore është prezantuar në një sërë manifestimesh dhe festivalesh teatrore dhe filmike brenda dhe jashtë vendit. Projektet e saj kanë marrë çmime prestigjioze, si dhe ka themeluar Festivalin Ndërkombëtar të Monodramës në Kosovë "MonoAKT" (2009), që është anëtar i Asociacionit Ndërkombëtar të Monodramës. Në vitin 2013 kjo shtëpi teatrore themeloi Institutin Hulumtues Teatror ITI - Qendra për Kosovë. Në Kosovë funksionojnë edhe disa shoqata e institucione për teatër dhe dramë, si: Qendra "Multimedia" e cila ka produksionin e vet skenik-teatror; Teatri laborator "Loja", i cili merret me inskenimin e formave të reja

skenike; Qendra "ArtPolis"; Teatri për fëmijë dhe të rinj "Kacagjelat" me seli në Mitrovicë, që ka funksionuar në vitet 1993-1997 dhe gjatë viteve 1999-2005 etj. (Emin Emini)

TEJECI Hyrë (1973-). Gazetare. Lindi në Prizren. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, ndërsa studimet për matematikë në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore të Universitetit të Prishtinës. Një kohë punoi mësimdhënëse e matematikës. Nga viti 2001 punoi gazetare në Radiotelevizionin-21 dhe më pas në Radio-Kosovë, si autore emisionesh dhe redaktore. Specializoi gazetarinë në qendra të ndryshme të medias elektronike, si në Paris, Berlin, Nju-Jork etj. Mori disa çmime prestigjioze për reportazhet më të mira në radio, të cilat trajtonin çështje sociale, apo dhunën ndaj femrës, ndër të cilët edhe çmimin "Grand" të Unionit Europian të Transmetimit (EBU) për projektin "Unë jetoj në Ballkan", si dhe çmimin special për radio "Lorenzo Natali" të Komisionit Europian në Strasburg. (Shaqir Foniqi)

TEKSTET SHKOLLORE. Tekstet shkollore në gjuhën shqipe në Kosovë zënë fill në shek. XIX. Me fillimin e shkollimit të rregullt shqip më 1941 dhe më vonë, shfaqet nevoja edhe për tekste shkollore adekuate. Në vitet 1941-1944 ishin në përdorim tekste shkollore të botuara në Tiranë. Pas Luftës së Dytë Botërore, tekstet shkollore shqipe fillimisht u botuan në Beograd, pastaj në Prishtinë. Vendimi për botimin e tyre merrej në institucionet e Serbisë. Tekstet shkollore për nxënësit serbë silleshin nga Beogradi, ndërsa për nxënësit turq silleshin nga Shkupi. Deri në vitet '70 të shek. XX, shumica e teksteve mësimore në gjuhën shqipe, sidomos të shkencave ekzakste, ishin të përkthyer nga gjuha serbokroate. Në vitin 1972, nga 220 tituj tekstesh shkollore origjinale, me autorë shqiptarë ishin vetëm 70 sish. Numri i autorëve shqiptarë dhe i teksteve shqipe rritet gjatë viteve në vazhdim. Në periudhën 1970-1990 për arsimin fillor në gjuhën shqipe u botuan ose u ribotuan 1,108 tekste, në gjuhën serbe 120 dhe në gjuhën turke 44 tekste shkollore. Për shkolla të mesme, gjatë kësaj periudhe u botuan apo u ribotuan 1,050 tekste shkollore. U botuan edhe tekste universitare. Të gjitha këto u shtypën nga Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore në Prishtinë. Në periudhën 1990-1999 u ribotuan

kryesisht tekstet ekzistuese, por në vitin 1994 filluan të botohen edhe tekste të përbashkëta shqipe me autorë nga Kosova dhe Shqipëria. Deri në vitin 2004 ishin në përdorim rreth 70 tekste të tilla nga lëndë shoqërore-humanitare. Ribotimin e teksteve (192 tituj) për vitin shkollor 1999/2000 e financoi konzorciumi i donatorëve dhe nxënësve iu shpërndanë falas. Në vitin 2004 filloi botimi i teksteve shkollore sipas kurikulës së re, nën mbikëqyrjen e Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë së Kosovës. Botuesit kryesorë të teksteve shkollore në Kosovë janë SHB "Libri shkollor", "Dukagjini", "Albas" etj. U botuan tekste edhe për mësim në gjuhën boshnjake dhe turke. Viteve të fundit ka filluar botimi i teksteve alternative, ndërsa tekstet e gjuhës angleze për shkollën fillore dhe të mesme u sollën nga Britania e Madhe. Në mungesë të teksteve të reja, prej vitit 2010 vazhdon ribotimi i teksteve shkollore ekzistuese. (Bajram Shatri)

TEKSTET UNIVERSITARE. Tekstet universitare në Kosovë lidhen me themelimin dhe veprimtarinë botuese të Universitetit të Prishtinës. Botimi i teksteve universitare filloi në vitin 1970, kur u botuan 13 tekste në gjuhën shqipe, shumica të Universitetit të Tiranës. Numri i tyre rritet gjatë viteve në vazhdim, me përkthime nga gjuha serbokroate. Gjendja fillon të përmirësohet pas vitit 1976, kur, përveç shtimit të numrit të teksteve në gjuhë shqipe, bëhen përpjekje edhe për hartimin e teksteve origjinale nga mësimdhënësit e Universitetit të Prishtinës. Për vitin akademik 1978/79 planifikohen dhe botohen disa dhjetëra tituj tekstesh universitarë në gjuhën shqipe. Përdoren, gjithashtu, edhe tekste universitare në gjuhën serbokroate. Në periudhën 1970-1989 u botuan 420 tituj tekstesh universitarë, prej tyre 258 tituj të rinj në gjuhën shqipe. Botimin e tyre gjatë kësaj periudhe e financoi BVI-ja e Shkencës dhe e Arsimit e Kosovës. Botimi i teksteve universitare bëhej sipas një procedure të veçantë. Kjo veprimtari vazhdoi edhe në kushtet e administratës së dhunshme serbe. Politika dhe praktika e botimit të teksteve origjinale shqipe pësoi ndryshime pas vitit 2000, kur u shtrua nevoja për tekste më cilësore nga autorë eminentë të huaj dhe për përkthimin e tyre. (Bajram Shatri)

TELAKU Jusuf (1936-). Mjek, neuropsikiatër, profesor universiteti. Lindi në Banjë të

Malishevës, shkollën fillore e kreu në vendlindje dhe në Rahovec, kurse gjimnazin në Prizren. Punoi si mësues për disa vjet. Kreu Fakultetin e Mjekësisë në Shkup (1967). Pas diplomimit punoi në Malishevë dhe Drenas, ku ishte edhe drejtor i shtëpisë së shëndetit. Më 1972 kaloi në Klinikën e Neuropsikiatrisë të Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë. U specializua në Universitetin e Zagrebit, u emërua asistent i neuropsikiatrisë (1978). Temën e doktoratës e mbrojti në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë më 1988, më pas u zgjodh docent, profesor inordinar dhe profesor ordinar i lëndës së neuropsikiatrisë (1989). Gjatë luftës në Kosovë ofroi ndihmë mjekësore në zonat e luftës. Mori pjesë në disa kongrese e simpoziume dhe publikoi një sërë punimesh shkencore, si autor dhe bashkautor. (Jusuf Ulaj)

TELEVISIONET NACIONALE, RAJONALE DHE LOKALE. Janë televizione me shikueshmëri në tërë territorin e Kosovës, ose në një hapësirë më të kufizuar, të licencuar nga Komisioni i Pavarur i Medieve (KPM). Gjithsej në Kosovë, deri në vitin 2016, janë të licencuar 20 televizione. Tre televizione kanë frekuenca nacionale (Radiotelevizioni i Kosovës, Radiotelevizioni-21 dhe "Kohavision"), 12 televizione kanë frekuenca rajonale, kurse 5 janë televizione lokale. Nga ky numër, 11 televizione transmetojnë program në gjuhën shqipe, 3 televizione transmetojnë program në gjuhën serbe, 5 televizione transmetojnë program në dy ose në tri gjuhë, kurse 1 televizion transmeton program në 5 gjuhë. Funksionimi i televizioneve është i rregulluar me Ligjin nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Medieve, me përjashtim të televizioneve RTK-1 dhe RTK-2, funksionimi i të cilëve rregullohet me Ligjin 2011/04-L-046 për Radiotelevizionin e Kosovës. Ndërkaq, televizione lokale dhe rajonale janë:

TV Ballkan, televizion rajonal me seli në Prizren, që transmeton program në gjuhën turke, shqipe dhe boshnjake.

TV Besa, televizion rajonal me seli në Prizren, i licencuar nga KPM-ja më 2009. Transmeton program në gjuhën shqipe dhe turke;

TV Dukagjini, televizion lokal, me seli në Pejë, që transmeton program në gjuhën shqipe.

TV Festina, televizion lokal, me seli në Ferizaj, që mbulon rajonin e Gjilanit dhe transmeton program në gjuhën shqipe;

TV Herc, televizion rajonal me seli në Shtërpçë, që transmeton program në gjuhën serbe dhe në gjuhën shqipe;

TV Mir, televizion rajonal me seli në Leposaviq, që mbulon rajonin e Mitrovicës dhe transmeton program në gjuhën serbe;

TV Mitrovica, televizion rajonal me seli në Mitrovicë, që transmeton program në gjuhën shqipe;

TV Most, televizion lokal me seli në Zveçan, që transmeton program në gjuhën serbe;

TV Opinion, televizion rajonal, me seli në Prizren, që transmeton program në gjuhën shqipe;

TV Prizreni, televizion rajonal me seli në Prizren, që transmeton program në gjuhën shqipe.

TV Puls, televizion lokal me seli në Gjilan, që transmeton program në gjuhën serbe;

TV Tema, televizion lokal me seli në Ferizaj, që transmeton program në gjuhën shqipe, serbe dhe rome;

TV Syri Vision, televizion rajonal me seli në Gjakovë, që transmeton program në gjuhën shqipe.

TV Vali, televizion rajonal me seli në Gjilan, që transmeton program në gjuhën shqipe. (Hyra Tejeci)

TELEVISIONI "KLAN KOSOVA". Nisi transmetimin në Prishtinë në vitin 2009, i themeluar nga Televizioni "Klan" i Tiranës, me drejtor dhe koordinator gazetarin Baton Haxhiu.



Në fillim transmetoi vetëm emisionin e lajmeve të orës 20, ndërsa pas disa javësh nis edhe emisionin e mëngjesit, duke vazhduar më pas me emisione të tjera informative,

dokumentare dhe më vonë me emisione të kontaktit, si "Zona B" dhe "Zona e debatit". Në fillim një pjesë e programit ishte prodhim i studios së Tiranës të TV "Klan", ndërsa më vonë "Klan Kosova" zhvilloi prodhimin e pavarur të emisioneve televizive. Në emisionet e lajmeve u bënë përpjekje të futen risi në mënyrën e raportimit për zhvillimet aktuale në Kosovë. "Klan Kosova" u përpoq të sillte përvojë të re në raportimet nga fushatat zgjedhore dhe zhvillimin e zgjedhjeve, duke transmetuar

emisione speciale dhe duke u lidhur me reportere në të gjitha komunat më të rëndësishme të Kosovës. Edhe emisionet e mëngjesit dhe të pasdites, të formatit miks, ndikuan në ndryshimin e skemave programore të televizioneve të tjera të vendit. Për punë të suksesshme, "Klan Kosova" mori çmime dhe mirënjohje, kryesisht për trajtesat sociale dhe për cilësi dhe kreativitet të xhirimeve. Së fundi, "Klan Kosova" mbulon skemën e vet programore gati 90 % me produksionin e vet. Nga viti 2015 transmeton në teknikën HD. (Gazmend Sylja)

TELEVIZIONI "KOHAVISION" (KTV). Transmetues privat, njëra nga mediet elektronike me licencë kombëtare në Kosovë. Është pjesë e Grupit "Koha", në kuadër të të cilit ve-



pron gazeta e përditshme, veprimtaria botuese, shtypshkronja, si dhe kanalet televizive "Kohavision" dhe "Arta". "Kohavision" ka filluar transmetimin menjëherë pas luftës

në Kosovë, në vitin 2000, dhe nga fillimi u shqua me përmbajtje të paanshme informative, programe kulturore, argëtuese, dokumentare, te realizuara nga ekipet e saj apo të huazuara nga produksione të huaja. Informimi është veprimtari parësore e KTV-së jo vetëm me lajme dhe informata nga terreni, por edhe me analiza dhe debate në studio, me emisione që synojnë të prekin çështjet më akute të shoqërisë kosovare. KTV ka njërin nga programet më të shikuara informative, me lajme nga vendi dhe bota. Gjithashtu janë mjaft të ndjekur emisionet: "Rubikon", "Interaktiv", "Ekspress", "Sot", "Puls", pastaj emisionet e kulturës, serialet dhe emisionet argëtuese, si dhe transmetimet e ndeshjeve ekskluzive sportive. Një përqindje të rëndësishme zë dhe programi i huazuar, filma, seri televizive, programe dokumentare, që prezantohen të përkthyer apo të sinkronizuar në gjuhën shqipe. "Kohavision", përveç në rrjetin tokësor transmetohet edhe në satelit si dhe në platformat digjitale në Kosovë dhe jashtë, 24 orë, pa ndërprerë. (Ibrahim Berisha)

TEMA E SHKUPIT. Njësi administrative-ushtarake e Perandorisë Bizantine. Kryeqendra e Dardanisë antike, Shkupi, në fillim të shek.

XI ishte në kuadër të Perandorisë Bullgare. Në vitin 1004, qyteti u pushtua nga perandori bizantin Basili II (976-1025). Pasi i dha fund ekzistencës së shtetit bullgar (1018), Basili II krijoi Temën e Shkupit, me seli në këtë qytet. Ai emëroi në postin e strategut të kësaj Teme të parin e familjes feudale arbërore të Arianitëve, patricin David Arianitin. Tema e Shkupit përfshinte Dardaninë (Kosovën), Serbinë e sotme në jug të Danubit, thuajse të gjithë Maqedoninë dhe një pjesë të Bullgarisë Perëndimore. Por udhëheqësi i kryengritjes kundër Bizantit, Pjetër Deliani, e mori Shkupin me ndihmën e popullsisë vendase (1040). Në vitet 1072-1073, paria e këtij qyteti, me në krye Gjergj Bojtekun u çua në kryengritje kundër Bizantit, por ajo nuk dha ndonjë rezultat. Nga ana tjetër, peçenegët shkretuan vendbanimet mes Nishit dhe Shkupit (1079-1080). Shkupi u pushtua përkohësisht nga normanët (1082), ndërsa rrethina e tij u dogj nga rasanët (serbët, 1093). Më pas ai kaloi një periudhë të qetë nën sundimin bizantin, derisa më 1190, kur u shkretua nga zhupani i madh i Rashës, Stefan Nemanja (1166-1196). Gjatë shek. XIII Shkupi ra nën sundimin e Bullgarisë, të Principatës së Prosekut, të despotatit të Epirit, të Perandorisë së Nikesë, të Perandorisë Bizantine dhe nga viti 1282 nën Mbretërinë e Rashës (Serbisë). Shkupi ishte njëra nga selitë e mbretit rasianserb, Stefan Dushani (1331-1346), i cili u kurorëzua aty perandor (1346-1355). Në këtë qytet u shpall Kodi i Stefan Dushanit (1349), dokument juridik dhe dokesor serb. Pas vdekjes së Dushanit (1355), qyteti deri më 1366 mbeti nën sundimin e djalit të tij, Uroshit V (1355-1371). Gjatë viteve 1366-1371, Shkupi ishte pjesë e zotërimeve të sundimtarit të Maqedonisë Perëndimore dhe të një pjese të Dardanisë (Kosovës), Vukashinit dhe më pas nën sundimin e feudalit Vuk Brankoviq. Në kohën e sundimtarëve rasianserbë, në krye të Shkupit qëndronte qefaliu, i cili kishte edhe pushtet juridik. Më 1377 Shkupi kishte dy qefali: njëri i qytetit të Poshtëm (Varoshit) dhe tjetri i qytetit të Epërm (Kalasë). Më 1391-1392, Shkupi u pushtua nga osmanët, të cilët e shndërruan në bazë të fuqishme ushtarake, prej nga më vonë u nisën ekspeditat pushtuese ndaj viseve të tjera arbërore. (Qerim Dalipi)

TEMO Ibrahim (1865-1945). Mjek, oftalmolog, veprimtar i çështjes kombëtare. Lindi



IBRAHIM TEMO

në Strugë. Më 1884 u regjistrua në shkollën e mesme të mjekësisë në Ahirkapida, e më pas në shkollën mjekësore ushtarake në Bogaz. Pas kryerjes së studimeve specializoi për oftalmologji. Ishte aktiv në lëvizjen kombëtare. Themeloi Komitetin “Bashkim e përparim”, që luftonte kundër regjimit absolutist turk. U arrestua disa herë. Më 1895 ik në Rumani, ndërsa një vit më vonë filloi punën e mjekut në qytetin Mexhidie të Dobruxhës. Nuk u pajtua me politikën e xhonturqve. Në maj të vitit 1914 shkoi në Shqipëri, me një grup mjekësh të Kryqit të Kuq të Rumanisë për ta luftuar malarin. Më 1919 ishte delegat në Konferencën e Paqes në Paris, si përfaqësues i kolonive shqiptare të Rumanisë, Turqisë dhe SHBA-së. Dha kontribut të çmuar për njohjen e Lidhjes Shqiptare të Pejës. Ishte iniciator për botimin e thirrjes “Rruga e shpëtimit është në Besa-Besë”, që ishte një nga aktet më të rëndësishme të Lidhjes së Pejës. Më 22 prill të vitit 1899, në Bukuresht, botoi broshurën “Të zgjohemi”. Pas vetes la një numër të madh shkrimesh e dorëshkrimesh. Vdiq në Konstancë të Rumanisë. (Isuf Dedushaj)

TEMPULLI I ANTINOUT. Shih: **MUNICIPIUM DD.**

TEQETË (sh. XVI-XX). Objekte të kultit islam, që filluan të ndërtohen në Kosovë që në sh. XVI, bashkë me përhapjen e tarikatit të dervishëve. Edhe pse nuk veçohen me monumentalitet, këto ndërtime zënë një vend në arkitekturën tradicionale të Kosovës. Ato, krahas vlerave arkitekturale, kanë pasur edhe rëndësi fetare, kulturore dhe historike. Godinat ekzistuese të teqeve në Kosovë i takojnë periudhës së sh. XVIII-XIX. Disa objekte e kanë ruajtur gjendjen fillestare, por aty-këtu janë bërë edhe transformime dhe janë shtuar anekse të veçanta. Ndërtimet kryesisht i takojnë arkitekturës qytetare. Përbëhen nga shtëpia e banimit me samahon dhe nga tyrbja me varreza të personaliteteve eminente të tarikatit të dervishëve. Samahoni është vendi ku mblidhen dervishët dhe bëhen ritualet fetare. Samahoni, pos mihrabit dhe galerisë, mund të ketë edhe dekorime pikturale të realizuara në seko

teknikë. Motivet janë të karakterit dekorativ, si figura gjeometrike, arkitekturale dhe citate me përmbajtje fetare islame. Përveç pikturave dhe objekteve të ndryshme ceremoniale, teqetë kanë dhe biblioteka të pasura me dorëshkrime. (Orges Drançolli)

TEQETË. Vende ku qëndrojnë dervishët dhe i kryejnë adhurimet e tyre të veçanta. Teqetë janë vende ku është punuar, analizuar, përjetuar mendimi mistik islam dhe i është prezantuar



TEQEJA E RAHOVECIT

popullatës. Si institucione të mistikës islame dhe pjesë përbërëse të qytetërimit islam, paraqesin institucione edukuese fetare, në të cilat banojnë ose qëndrojnë ithtarët e tarikatit (muridë, muhibë), të cilët nën përkujdesjen e një shehu përpiqen ta zbukurjnë moralin dhe etikën e tyre në bazë të parimeve mistike islame. Teqetë e para u shfaqën që në shekujt e parë pas profetit Muhamed, në formë të rabateve, që ishin kazerma ushtarake periferike të ushtrisë myslimane, të cilat me kohë humbën funksionin e tyre ushtarak dhe u bënë strehë për sufinjtë e ri dhe dervishët. Më vonë në qendrat dhe vendet periferike të botës islame, si dhe të vendeve joislame, janë ndërtuar godina të posaçme, të cilat, varësisht nga tarikati, forma dhe madhësia janë emërtuar si: zavie, hankah, ribat, mevlevihane, kalenderhane, dergah, pirevi, sofihane, kadirhane, asitane etj. Teqetë patën ndikim në jetësimin e parimeve islame dhe në përhapjen e islamit, sikundër që ushtruan ndikim në shumë aspekte të jetës shoqërore dhe kulturore të komunitetit, përfshirë edhe hapësirat shqiptare. Pothuajse të gjithë tarikatet, që kanë qenë të përhapur në botën islame i kanë teqetë e tyre edhe në trojet shqiptare, përfshirë edhe Kosovën. (Metin Izeti)

TERMOELEKTROCENTRALET (TEC) “KOSOVA A”. Përbëhen nga pesë njësi (bloqe) të pavarura prodhuese, me fuqi instaluese nga 65-210 MW. Janë ndërtuar në periudhën 1960-



TERMOCENTRALI “KOSOVA A”

1975. Ndodhen afër minierave të qymyrit në Obiliq, rreth 10-15 km nga Prishtina. Bloqet e termoelektrocentraleve A1 dhe A2, për shkak të vjetërsisë, që nga viti 2000 nuk janë në prodhim. Tani në prodhim ndodhen dy nga bloqet A3, A4 ose A5, ndërsa njëri përdoret si rezervë e nxehtë. Turbinat e këtyre bloqeve janë aksiale të tipit me kondensim dhe punojnë sipas ciklit të Rankinit. Prodhimi vjetor i energjisë elektrike nga TEC-i “Kosova A” është rreth 1,500 GWh. Gjeneratori i avullit është me konstruktion të lirë gjysmë të varur, me skemë avull-ujë me dy tambura dhe me qarkullim natyror. Secili gjenerator i avullit të bloqeve A3, A4 dhe A5 është i pajisur me nga 8 mullinj të tipit ventilatorik, secili me kapacitet 40-60 t/h. Furnizimi me ujë bëhet nga vendmarrja në lumin Llap, ku është ndërtuar penda, ndërsa në kushtet e thatësisë shfrytëzohet uji nga sistemi “Ibër-Lepenc”. Furnizimi me qymyr bëhet nga xeherorja e Mirashit, miniera e Sitnicës dhe e Sibocit. Një TEC me fuqi prej 200 MW shpenzon rreth 300 t/h qymyr me nxehtësi të djegies rreth 7,500 kJ/kg. Largimi i hirit dhe i zgjyrës nga kaldajat bëhet me sistem hidraulik, pas formësimit të hidropërzierjes (hi, zgjyrë dhe ujë), e cila me pompa dërgohet në deponinë e Sitnicës. (Fejzullah Krasniqi)

TERMOELEKTROCENTRALI (TEC) “KOSOVA B”. Përbëhen nga dy njësi të pavarura prodhuese (bloqe) me fuqi instaluese nga 339 MW, të ndërtuar në periudhën 1977-1984. Prodhimi vjetor i energjisë elektrike nga TEC



TERMOCENTRALI “KOSOVA B”

“Kosova B” është rreth 3,650 GWh. Gjeneratori i avullit është i tipit pyrgor me qarkullim të detyrueshëm të ujit me kapacitet prodhues rreth 1,000 t/h avull të tejnxehur me presion 177.4 bar dhe temperaturë 540°C. Presioni i kondensimit të avullit është 0.0607 bar. Gjeneratori i avullit është prodhuar nga firma franceze “Stein Industri”. Furnizimi me qymyr bëhet nga mihjet sipërfaqësore të Bardhit dhe Mirashit. Gjeneratori i avullit furnizohet me qymyr nga 8 mullinj ventilatorikë, secili me kapacitet të bluarjes 45-73 t/h. Turbina është e tipit kondensues, e prodhuar nga kompania gjermane “MAN”. Ajo përbëhet nga tri shtëpiza: nga turbina e presionit të lartë, të mesëm dhe të ulët (TPL, TPM dhe TPU), rotorët e të cilave janë të lidhura me lidhje të ngurtë. Avulli pas TPL-së rritejnxehet dhe shkon në TPM. Furnizimi me ujë i TEC “Kosova B” bëhet nga liqeni i Ujmanit, nëpërmjet sistemit “Ibër-Lepenc”. Shpenzimi i ujit të dekarbonizuar të një blloku të TEC “Kosova B” është 2.1-2.6 m³/MW, ndërsa shpenzimi i ujit të demineralizuar është 0.06-0.12 m³/MW. Largimi i hirit dhe i zgjyrës bëhet me sistem hidraulik, pas formësimit të hidropërzierjes (hi, zgjyrë dhe ujë), e cila me pompa dërgohet në deponinë e Sitnicës. (Fejzullah Krasniqi)

TERTORJA E QYMYRIT, OBILIQ. Shfrytëzimi i qymyrit në basenin e Kosovës filloi më 1922, kryesisht për nevoja të amvisërisë. Më vonë qymyri shërbente si lëndë djegëse për prodhimin e energjisë elektrike. Me zhvillimin e teknologjisë dhe rritjen e kërkesave për qymyr cilësor, u shfaq edhe nevoja e terjes së qymyrit. Qymyri i papërpunuar i basenit të Kosovës përmban rreth 50% lagështi, prandaj ka vlerë të ulët termike. Pas shumë analizave

dhe studimeve, u zgjodh metoda e terjes sipas "Fleissiner-it", përmes së cilës arrihet zvogëlimi i lagështisë deri në 20%. Në tertoren e Obilicqit janë prodhuar 730,000 tonë qymyr të terur në vit. Pajisjet përbëhen nga 12 autoklava me vëllim të njëjtë. Procesi i terjes zgjat rreth 60 minuta. Terja e qymyrit kryhet me avull të ujit në shtypje prej 31 atmosferash dhe temperaturë 236°C. Aftësia termike e qymyrit të terur rritet nga 7500 kJ/kg në 12, 500 kJ/kg. Uji i larguar gjatë procesit të terjes (360,000 l/v) grumbullohet në rezervuar dhe më pastaj derdhet në lumin Sitnica. Kjo sasi e ujit hedhurinë paraqet problemin kryesor në ndotjen e mjedisit, për shkak të përmbajtjes së fenoleve. Viteve të fundit impianti i terjes së qymyrit u nda nga KEK-u dhe kaloi në shoqëri aksionare. Tertorja e qymyrit mund të aktivizohet në prodhim vetëm në sajë të kërkesave të konsumatorëve. Qymyri i terur shërbente si lëndë e parë në prodhimin e gazit në procesin e gazifikimit dhe si lëndë djegëse për qëllime industriale dhe ngrohje qendrore. (Shefqet Rashani)

TERZIQI Avni (1950-). Inxhinier i makinerisë, profesor universiteti. Lindi në Mitrovicë, ku kreu shkollën fillore dhe të mesme. Fakultetin Teknik e kreu në Prishtinë (1975),



AVNI TERZIQI

ndërsa studimet e magistraturës në Fakultetin e Makinerisë të Universitetit të Shkupit. Në vitin 2001 mbrojti tezën e disertacionit të doktoratës në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike të Universitetit të Prishtinës (UP). Në periudhën 1976-1979 dhe 1986-1990 punoi në shkretoren e plumbit "Trepça" si udhëheqës i mirëmbajtjes, drejtor teknik, udhëheqës i investimeve, etj. Në vitet 1979-1980 ishte mbikëqyrës i punimeve makinerike në Pallatin e Rinisë në Prishtinë. Që nga viti 1979 u përfshi në procesin mësimor në Shkollën e Lartë Teknike, në Fakultetin e Shkencave Teknike të Aplikuara dhe në Fakultetin e Xehetarisë dhe të Metalurgjisë të Universitetit të Prishtinës, duke arritur titullin profesor i rregullt për lëndët: termodinamika, mekanika e fluideve, makinat me pistona, gjeometria deskriptive etj. Është autor dhe bashkautor i një sërë punimesh shkencore të publikuara në revistat vendore

dhe ndërkombëtare. Botoi tekstin universitar "Makinat me pistona" dhe disa dispensa. Kreu edhe funksione të ndryshme në organet drejtuese të UP-së dhe të Universitetit të Mitrovicës. (Fejzullah Krasniqi)

TERZIQI Hamdi (1947-). Grafist. Lindi në Mitrovicë. Kreu Fakultetin e Arteve Figurative, drejtimin e grafikës në Beograd. Në grafikat e tij në plan të parë pasqyrohen elementet gjeometrike, si rrathët, katrorët, derisa në mes sajohen forma përmbajtësore me shprehje dekorative, të realizuara kryesisht në teknikën e akuatintës, me ngjyrë kafe dhe okër. Hapi ekspozita personale në Mitrovicë (më 1970 dhe 1977) dhe mori pjesë në ekspozita kolektive të Shoqatës së Artistëve Figurativë të Kosovës në Prishtinë (1977- 1983), në Sallonin Pranveror të Kosovës, në Bienalen e vizatimit (III-V), në ekspozitën e grafikës bashkëkohore të Kosovës në Këln (1978), pastaj në Paris (1979), si dhe në Palermo, Kozencë, Damask, Tiranë, Beograd, Zagreb (1980), Montreal (1981), Dubrovnik (1982), Malmo (1983), Londër, Gllasgou (1984), Dejton, Belfast, Kajro, Shtutgart (1985), Dagestan (1987), Zagreb (1990) dhe Stamboll (1997). Jeton në Francë. (Fatmir Krypa)

TERZIU Nazim (1977-1998). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), dëshmor. Lindi në fshatin Sllatinë të Lepencit. Në maj të vitit 1998 iu bashkua njësitit të UÇK-së në Kaçanik, ndërsa dy muaj më vonë shkoi në Shqipëri për stërvitje ushtarake dhe për t'u pajisur me armë. Në fillim të shtatorit u kthye në Kosovë, në njësitin e Kaçanikut në Jezerc. Më 24 shtator 1998 forca të shumta ushtarake dhe policore serbe ndërmorën një ofensivë të madhe kundër UÇK-së në Zonën Operative të Nerodimes. Më 28 shtator 1998 ushtria serbe nga Nerodimja filloi depërtimin për Jezerc. Luftimet u zhvilluan ballë për ballë dhe në këtë betejë ranë disa luftëtarë të UÇK-së, përfshirë edhe N. Terziun. (Hajrush Kurti)

TERRITORI I DARDANISË. Dardania zinte hapësirat qendrore të Europës Juglindore. Territori parahistorik përfshinte hapësirat midis lumenjve Brong (Moravë), Timacus (Timok), Axios (Vardar), Astibo (Bregallnicë) dhe rrjedhës së epërme të Drinit. Sipas Herodotit (shek. V), lumi Angri (Morava Jugore) dilte nga toka e ilirëve, futej në fushën e

tribalëve dhe derdhej në lumin Brong (Morava) dhe ky në Ister (Danub). Fqinjët e dardanëve në veri ishin tribalët, në verilindje mezët, në lindje medët, besët e dentelejët, në juglindje peonët, në jug pellagonët, në perëndim pirustët, ardiejë të dhe autariatët dhe në veriperëndim dasaretët. Pas krijimit të shtetit dardan (shek. IV-I p.e.r.) në të u përfshinë dhe tokat e autariatëve, të tribalëve, të taulantëve dhe, më pas, të peonëve. Në veri kufijtë përfshinin territoret përgjatë luginës së Nishavës, duke zënë prapavijën e Nishit me Aleksincin dhe Knjazhevcin në Serbi. Pas pushtimeve romake, Dardania u bë pjesë e provincës romake të Mezisë dhe pastaj e Mezisë së Epërme (86), ndërsa pas reformave të Dioklecianit (279), u krijua Provinca e Dardanisë, me kufij përafërsisht të njëjtë me kufijtë e shtetit të dikurshëm dardan. (Edi Shukriu)

TETOVA Abdurrahman Pashë. (?-1840). Pushtetar lokal dhe donator i rëndësishëm i periudhës osmane në Tetovë. Rrjedh nga familja e Derrallajve, i biri i Rexhep Pashë Plakut. Mbante nën pushtetin e tij tërë fushën e Pollogut, deri në kufi të Kaçanikut. Mori pjesë në lëvizjen kryengritëse të pashallarëve shqiptarë kundër reformave centralizuese të pushtetit qendror osman të viteve '30 të shek. XIX. Në fillim të vitit 1834, A. Pasha u thirr në Stamboll, prej nga nuk u kthye më. Vdiq i syrgjynosur nga sulltani në vitin 1840. Bëri ndërtime dhe rinovime të ndryshme në Tetovë. Financoi dekorimin e Xhamisë së Larme të ndërtuar në vitin 1495, ndërsa në vitin 1821 ndërtoi një urë afër asaj xhamie. Vepra më e rëndësishme e tij është Kalaja e Tetovës, të cilën e kishte nisur i ati i tij, Rexhep Pasha. Kalaja u ndërtua në kodrën Ball-tepe, mbi Tetovë, nga e cila kontrollohej tërë fusha e Pollogut. (Nehat Krasniqi)

TETOVA Aqif (1873-1944). Veprimtar anti-komunist. Lindi në Tetovë. I ati, Islam Tetova, ishte patriot i njohur i Rilindjes Kombëtare. A. Tetova ishte bashkëpunëtor i Hasan Prishtinës dhe Ilaz Agushit. Pas rënies së Mbretërisë Jugosllave në prill të vitit 1941 ndihmoi themelimin e administratës shqiptare në nënprefekturën e Gjilanit. Punoi edhe si gazetar. Ishte delegat i Gjilanit në kuvendin themelues të Lidhjes së Dytë të Prizrenit, në shtator të vitit 1943 dhe pjesëmarrës në

Kuvendin Kombëtar të Tiranës, në tetor të vitit 1943. Bashkëpunoi edhe me Hysen Tërpezën në organizmin e rezistencës kundër njësiteve partizane të Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Jugosllavisë gjatë muajve korrik-nëntor të vitit 1944 në Kosovën Verilindore. Pas hyrjes së njësiteve partizane në Gjilan, më 16 nëntor 1944, bashkë me shumë veprimtarë shqiptarë, u burgos në Gjilan dhe u ekzekutua pas disa ditësh. (Adem Murati).

TETOVA Hasan Pashë (gjysma e parë e shek. XIX). Figurë e shquar e Lëvizjes kombëtare. Ishte djali i Rexhep Koxha Pashës së Tetovës. Hasan Pasha nga vëllai i tij i madh, Abduraman Pasha, u vu në krye të gardës së Pashallëkut të Tetovës, kur në vitin 1822 ai trashëgoi pashallëkun nga babai i tij. Në vitin 1824 u emërua pashë i sanxhakut të Qustendilit. Mori pjesë në kryengritjen shqiptare të vitit 1831 kundër Portës së Lartë, në anën e Mustafa Pashë Bushatit. Në vitin 1840 erdhi deri te një grindje mes djemve të Koxha Rexhp Pashës, për shkak të trashëgimisë së zotërimeve të të atit. Porta e Lartë u njoftua për këtë ngjarje dhe u thirrën në Stamboll për hetime, si dhe për pajtim. Sulltani u kërkoi atyre që t'i dërgonin rekrutë për nevojat e ushtrisë. Këtë kërkesë vëllezërit nuk e pranuan, por kërkuan që shqiptarët ta kryejnë shërbimin ushtarak në trevat e veta. Për shkak të këtij refuzimi, vëllezërit nga Tetova, me familjet e tyre, u internuan në Stamboll. Kjo sjellje e Portës nxiti shqiptarët në revoltë kryengritjeje, që shpërtheu në vitin 1843, në krye me Dervish Carën. (Zeqirja Idrizi)

TË ARDHURAT BUXHETORE. Të ardhurat buxhetore përbëjnë tërësinë e të hyrave në kuadër të buxhetit të një vendi. Në Kosovë të ardhurat e buxhetit të Republikës përbëhen nga gjashtë kategori. Në kategorinë e parë bëjnë pjesë të hyrat nga tatimet, të cilat ndahen në të hyra vendore (që mbledhen nga Administrata Tatimore e Kosovës) dhe në të hyra doganore (që mbledhen nga Dogana e Kosovës). Në kategorinë e dytë bëjnë pjesë të hyrat jotatimore, të hyrat vetanake (të mbledhura në nivelin lokal e qendror), taksat koncesionare si dhe tantiemat. Në kategorinë e tretë të të hyrave bën pjesë dividenda, e cila mbledhet nga pasuritë në pronësi të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Në kategorinë e katërt bën pjesë mbështetja buxhetore nga donatorët.

Në kategorinë e pestë bëjnë pjesë grantet e projekteve, ndërsa në kategorinë e fundit bën pjesë fondi i mirëbesimit. (Lumir Abdixhiku)

TË ARDHURAT KOMBËTARE. Tërësia e të ardhurave të të gjithë zotëruesve të faktorëve të prodhimit, të përdorur për prodhimin e të mirave përfundimtare dhe për prodhimin e të mirave të ndërmjetme. Të ardhurat kombëtare përbëhen nga kompensimi i punëtorëve, të ardhurat e firmave joaksionare, të ardhurat e qirave, fitimet korporative, interesi neto si dhe taksat indirekte mbi bizneset. Në kompensimin e punëtorëve bëjnë pjesë pagat e punëtorëve dhe kontributet për sigurime shoqërore. Në të ardhurat e firmave joaksionare bëjnë pjesë të gjitha të ardhurat e bizneseve jo-korporata, të gjitha të ardhurat e individëve të vetëpunësuar (përfshirë dhe ato të fermerëve) si dhe të ardhurat e profesionistëve që ushtrojnë aktivitet privat. Në të ardhurat e qirave bëjnë pjesë të gjitha të hyrat e pronarëve nga qiradhënia e pronave të banimit, komerciale, bujqësore e jobujqësore. Fitimet korporative përbëjnë fitimin e pashpërndarë të korporatave, dividendat si dhe taksat mbi korporatat. Interesi neto shpërfaq dallimin në mes të interesit që individët ose bizneset marrin për kapitalin e dhënë hua dhe interesave që ata paguajnë. Në fund, taksat indirekte përmbajnë të gjitha taksat e vëna mbi vlerën e shtuar, taksat mbi pronën apo dhe taksat e akcizat e tjera. Në vitin 2014, sipas të dhënave të Bankës Botërore, të ardhurat kombëtare bruto në Kosovë, sipas paritetit të fuqisë blerëse, ishin 16,6 miliardë dollarë (12,5 miliardë euro), ndërsa të ardhurat kombëtare bruto (llogaritur sipas Bankës Botërore) ishin rreth 7,2 miliardë dollarë (përkatesisht 5,5 miliardë euro). (Lumir Abdixhiku)

TË DALAT (SHPENZIMET) BUXHETORE. Tërësia e mjeteve që shpenzohen nga buxheti i një vendi. Në rastin e Kosovës, shpenzimet buxhetore janë të ndara në katër kategori kryesore. Në kategorinë e parë bëjnë pjesë të gjitha shpenzimet rrjedhëse, të cilat ndahen në tri nënkategori: në paga e mëditje, në mallra e shërbime dhe në subvencione e transfere. Në kategorinë e dytë bëjnë pjesë të gjitha shpenzimet kapitale që ekzekutohen e financohen nga buxheti i shtetit. Në kategorinë e tretë bëjnë pjesë shpenzimet nga rezerva buxhetore, ndërsa në kategorinë e fundit bëjnë

pjesë shpenzimet e kredidhënies, kryesisht kreditë për asetet publike në pronësi të Qeverisë së Kosovës. (Lumir Abdixhiku).

TËRBESHI Ganimete (1927-1944). Aktiviste e Lëvizjes Antifashiste Nacionalçlirimtare, dëshmore. Lindi në Gjakovë. U përfshi në Lëvizjen Nacionalçlirimtare në Kosovë nën ndikimin e vëllait komunist, Abedin Tërbeshit. Më 1942 u bë anëtare e Bashkimit të Rinisë Komuniste në Kosovë. Pas vrasjes së Abedinit nga fashistët italianë, vazhdoi me vendosmëri veprimtarinë antifashiste. Shtëpia e saj u shndërrua në njërin nga bazat më të sigurta të veprimtarëve të Lëvizjes Nacionalçlirimtare. Në të u mbajtën mbledhjet e të rinjve komunistë dhe antifashistë, si dhe të grave të angazhuara në Lëvizje. Gjatë veprimtarisë në ilegalitet u zbulua dhe u burgos (1944). Pas një qëndrimi të shkurtër në burgun e Pejës, u internua në Kampin e Prishtinës. Së bashku me nëntë të burgosur antifashistë të tjerë, u varën në Namazgjah të Gjakovës më 23 gusht 1944. (Fehmi Rexhepi)

TËRBIMI. (*Rabies, Lyssa*). Antropozoonozë, sëmundje virusale akute, tejet e rrezikshme, e cila prek kafshët dhe njeriun. Sëmundja përfundon me vdekje. Rezervuar i sëmundjes janë dhelprat, lakuriqët e natës, si dhe kafshët e tjera mishngrënëse. Sëmundja te njeriu bartet përmes kafshimit. Dekadave të fundit tërbimi është sëmundje e rrallë te njeriu, por prek kryesisht kafshët e egra dhe ato shtëpiake në gjithë botën. Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë nga rabiesi janë të rrezikuar 2,5 miliardë njerëz. Në vendet e pazhvilluara dhe ato në zhvillim regjistrohen çdo vit 35,000 deri në 40,000 raste të vdekjeve nga tërbimi. Në të kaluarën në Kosovë janë regjistruar raste të tërbimit te njerëzit dhe situata epidemiologjike dhe epizootike me tërbim ka qenë shumë e rëndë. Prej vitit 1970 deri në vitin 1980 janë regjistruar 32 raste të sëmundjes te njerëzit, me po aq të vdekur, ndërsa në periudhën 1971-1980 janë regjistruar 229 raste të tërbimit. Nga viti 1981 deri më 2014 situata epidemiologjike paraqitet e qetë, pa asnjë rast të tërbimit te njerëzit. Kosova aplikon mbrojtjen antirabike sipas programit të imunizimit, ku vaksina dhe serumi jepen sipas indikacioneve epidemiologjike, si masë profilaktike dhe kundër-epidemike. (Ariana Kalaveshi)


TËRBOVIQI. Fshat rreth 5 km në verilindje të Pejës. Është vendbanim fushor, i ndarë në 4 lagje. Lartësia mbidetare është 474 m. Si vendbanim përmendet në disa dokumente të vjetra. Me emrin Trebnosh përmendet në defterin kadastral të sanxhakut të Shkodrës të vitit 1485, kurse me emrin Trebojk është regjistruar edhe në sallnamet e vilajetit të Kosovës të vitit 1893. Gjatë periudhës së Mbretërisë Jugosllave janë sjellë disa familje kolonësh malazezë. Në vitin 1948 kishte 458 banorë, kurse në vitin 2011 u regjistruan 1,950 banorë. Popullsia merret kryesisht me bujqësi. Ka shkollën 9-vjeçare, stacionin shëndetësor, disa dyqane tregtare etj. (Shpend Agaj)

TËRMETET. Lëvizje të menjëhershme dhe të papritura të korës së Tokës, të shkaktuara nga çlirimi i sforcimeve të grumbulluara në brendësi të saj, nga shpërthimi vullkanik ose të nxitura nga njeriu. Tërmetet shkatërruese shkaktohen vetëm nga zhvendosja e shkëmbinjve në brendësi të Tokës, përgjatë thyerjeve tektonike (tërmetet tektonike). Forca e tërmeteve shprehet në disa mënyra: me magnitudë, sipas shkallës së Rihterit (1-9), e cila shpreh forcën e tërmetit në vatër dhe shkallën e intensitetit sizmik (EMS-92, shkalla makrosizmike europiane, 1992), që shpreh intensitetin e efekteve të tërmetit në bazë të dëmeve dhe pasojave të shkaktuara në një lokalitet. Tërmetet në botë janë të përqendruar në disa zona ose breza sizmike (Mesdhetare, Paqësorit, Atlantikut). Kosova i takon brezit sizmik Mesdhetar, në të cilin kanë ndodhur tërmete të shumta dhe shpeshherë me pasoja të mëdha. Disa prej tërmeteve më të fuqishme, të cilat kanë goditur territorin e Kosovës, kanë qenë: i Prizrenit (1456, VIII ballë MSK-64, M=6.0), i Pejës (1662, VIII ballë MSK-64, M=6,0), i Ferizajt (1921, IX ballë MSK-64, M=6.1) dhe tërmetet më të vonshme: i Kopaonikut (1980, VIII ballë MSK-64, M=5,9) dhe i Gjilanit (2002, VIII-IX ballë MSK-64, M=5.7). (Hashim Këpuska)

TËRNAVA Hajrullah (1952-). Punëtor sportiv. Lindi në Lismir të Fushë-Kosovës. Përfundoi Akademinë Policore në Kamenicë të Sremit (Vojvodinë) dhe Akademinë e Lartë Policore në Beograd (1974-1976), si dhe Akademinë e Lartë në Shkup (1978-1981). Prej vitit 1968 nisi të merret me sportin e xhudos. Në vitin 1969 e zuri vendin e parë në kampionatin e Serbisë

në Beograd dhe në të njëjtin vit u shpall edhe kampion në kategori të lehtë për të rinj. Në vitet 1970/71 ishte kampion i Vojvodinës në këtë kategori dhe po atë vit në Novi-Sad u zgjodh sportist i vitit për të rinj. Në kampionatin e Kosovës ishte kampion për seniorë në vitet 1973-1978. Në kampionatin e Jugosllavisë (1973) zuri vendin e parë (70 kg) për seniorë. Prej vitit 1972-1976 bëri gara për ekipin "Partizan HINS" të Novi-Sadit, në ligën e parë federative të ish-Jugosllavisë. Në vitet 1972-1990 ishte trajner i përfaqësueses së Kosovës. Prej vitit 1985 deri 1990 kaloi në Drejtorinë e Policisë së Kosovës, ku punoi deri në korrik të vitit 1990. Gjatë viteve '90 u burgos disa herë dhe u dënua në mungesë me 6.5 vjet burg. Me këtë rast migroi në Gjermani. Në vitet 2000-2002 ushtroi ekipe të xhudos në Gjermani, duke arritur që klubin "Todtglusinger SV" ta çonte në Bundesligë. Në vitet 2007-2009 ishte kryetar i Federatës së Xhudos së Kosovës. (Lulzim Shala)

TËRNAVA Muhamet (1947-2017). Historian, profesor universiteti. Lindi në fshatin Lismir të Fushë Kosovës. Mbaroi shkollën fillore në vendlindje, ndërsa gjimnazin në Prishtinë. Studimet për histori i kreu në Fakultetin Filozofik në Prishtinë, ndërkaq studimet pasuniversitare i kreu në Zarë të Kroacisë, ku mbrojti tezën e doktoratës "Popullsia e Kosovës gjatë shekujve XIV-XVI". Për këtë studim bëri vjelje



MUHAMET
TËRNAVA

dokumentesh nëpër shumë arkiva dhe biblioteka, si të Parisit, Sorbonës, Beogradit, Shkupit, Tiranës e Prishtinës, Zarës, Dubrovnikut etj. Një kohë të shkurtër (1971/72) punoi në Institutin Albanologjik të Prishtinës dhe më pas, për afro dhjetë vjet, punoi në degën e historisë të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Në vitin 1982 u burgos dhe u dënua për shkaqe politike dhe, pas vuajtjes së dënimit, nuk u lejua të kthehej në Universitet deri në vitin 1995. Po në këtë vit u botua edhe disertacioni tij nga Instituti Albanologjik i Prishtinës. Ndërkohë, M. Tërnavë mori pjesë në tubime të ndryshme shkencore dhe botoi një sërë punimesh në revista të vendit dhe të huaja. Studimet e tij nga historia mesjetare u

botuan në përmbledhjen me titull "Studime për mesjetën" (1995), ku janë përfshirë tekste me interes shkencor, si "Shqiptarët në feudin e Deçanit", "Migrimet e popullsisë në territorin e sotëm të Kosovës gjatë shekujve XIV-XVI", "Shqiptarët në qytetet e Kosovës në shekujt XV-XVI", "Përhapja e islamizmit në territorin e sotëm të Kosovës deri në fund të shekullit të XVII", "Prizreni gjatë gjysmës së dytë të shek. XVI" etj., ndërsa më vonë botoi edhe monografinë "Kaçaniku me rrethinë deri në Luftën e Dytë Botërore" (1995). (Faik Sahiti)

TËRNAVA Myfti Naim (1961-). Titullar i fesë islame, myfti i Kosovës. Lindi në fshatin Lismir të Fushë-Kosovës. Shkollën fillore e mbaroi në vendlindje, kurse të mesmen në Medresenë



NAIM TËRNAVA

"Alaudin" në Prishtinë. Studimet për apologjetikë dhe filozofi islame i mbaroi në Universitetin "Al-Az-har" të Kajros (1984), ndërsa ato pas-universitare në Universitetin Amerikan po në Kajro (2003). Pas përfundimit të studimeve, kreu detyrën e imamit në Xhaminë e Lismirit (1984-1995). Në vitin 1985 u emërua pedagog i lëndës së akaidit dhe më pastaj edhe i filozofisë islame në Medresenë e Mesme "Alaudin" në Prishtinë, ku ishte edhe drejtor i saj (1995-2003). Nga viti shkollor 1994/95 është ligjërues i lëndës së akaidit dhe i filozofisë islame në Fakultetin e Studimeve Islame. Në periudhën 1999-2003 ishte kryetar i Kuvendit të Bashkësisë Islame të Kosovës, ndërkaq më 2003 u zgjodh kryetar dhe myfti i Bashkësisë Islame të Kosovës, funksion që e ushtron edhe tani. Mori pjesë në shumë konferenca, seminare, kongrese, simpoziume e forume brenda dhe jashtë Kosovës. Është autor i punimeve shkencore dhe artikujve publicistikë të botuar brenda dhe jashtë vendit, si dhe autor i disa monografive: "Morali islam" (1993), "Bazat e besimit" (1996), "Pasqyrë e filozofisë islame" (1995), "Fraksionet në islam" (1997) etj. dhe i përmbledhjes në dy vëllime "Ligjërime për fenë e atdheun" (2015). (Ramadan Shkodra)

TËRPEZA Hysen (1910-2002). Antikomunist, veprimtar nacionalist. Lindi në Tërpezë të Vitisë. Më 1916 familjen ia internuan pushtuesit



HYSEN TËRPEZA

bullgarë. Pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore kthehet në vendlindje. Që nga viti 1933 iu bashkua veprimtarëve patriotë të Anamoravës, duke i kundërshtuar padrejtësitë e Mbretërisë Jugosllave ndaj shqiptarëve. Gjatë periudhës së pushtimit italian (1941-1943) ishte kryetar i komunës në Pozhoran. U burgos nga policia italiane dhe ajo gjermane. Në korrik-nëntor 1944, së bashku me Idriz Gjilanin dhe bashkëveprimtarë të tjerë të Anamoravës, u ngrit kundër depërtimit të njësiteve partizane serbe e bullgare në territorin e Kosovës. Me Adem Gllavicën organizoi Kuvendin e Tërpezës më 1 dhjetor 1944, në të cilin u formua Shtabi Kryesor i Rezistencës në Kosovë. Më 15-16 gusht 1945 mori pjesë në Kongresin e Parë (III) të Lëvizjes së Rezistencës që mbahet në Tanushë të Kopilakës, ku u krijua Ushtria Popullore Demokratike Shqiptare dhe Shtabi Suprem i Luftës, në krye të të cilit u zgjodh H. Tërpeza. Në dhjetor të vitit 1945 u largua për në Greqi, pastaj emigroi (1949) ku iu bashkua Komitetit "Shqipëria Lirë" të Mithat Frashërit. Më 1956 u largua nga Italia dhe emigroi në SHBA. Në Kongresin e Parë të Lidhjes III të Prizrenit, në nëntor 1966 në Nju-Jork, u zgjodh nënkryetar. Kontaktoi dhe bashkëpunoi me mërgatën shqiptare dhe me personalitete të njohura botërore lidhur me çështjen shqiptare. Është autor i veprave "Ka me na gjykue Nana Kosovë" (Nju-Jork, 1972), "Unë Hysen Tërpeza, luftëtar i Shqipërisë Etnike" (1976) etj. Më 1995 u dekorua nga presidenti i Republikës së Shqipërisë me Medalje të Artë të Urdhrit "Skënderbeu". Pas çlirimit të Kosovës, pas 54 vitesh mërgimi, H. Tërpeza u kthye në Kosovë. Vdiq më 22 qershor 2002 dhe u varros në Varrezat e Dëshmorëve në Viti. (Adem Murati).

TËRSTENA Shaban (1965-). Mundës. Lindi në Shkup. Hapat e parë në mundje i bëri në vitin 1977, në klubin e mundjes "Liria" të Shkupit, nën drejtimin e trajnerit Muntas Allajbegu. U shpall 7 herë sportist i vitit në Maqedoni dhe një herë në ish-Jugosllavi. Është ndër sportistët më të suksesshëm shqiptarë, i cili arriti të fitojë medaljen e artë në Lojërat Olimpikë Verore



SHABAN TËRSTENA

(LOV) të vitit 1984 në Los Anxhelos të SHBA-së, si dhe fitues i medaljes së argjendtë në LOV në Seul (1988). Ishte kampion europian i vitit 1984 dhe 1990, fitoi medalje të argjendtë në vitin 1983, 1985, 1986 dhe të bronzë në vitin

1982 dhe 1988. Ka pasur rreth 800 ndeshje, prej të cilave vetëm 28 humbje. Ka marrë pjesë në 50 turne të ndryshme nëpër botë, duke fituar 50 medalje të arta. Edhe disa nga sukseset e Sh. Tërstenës: Kampion ballkanik në Stamboll (1980), vendi i tretë në Kampionatin Botëror (1981), vendi i tretë në Kampionatin Botëror në Katovicë të Polonisë (1982), vendi i tretë në Kampionatin Botëror në Kanada (1982), vendi i parë në Lojërat e Mesdheut në Kazablankë (1982), vendi i parë në Lojërat e Mesdheut në Latakia (1987) dhe vendi i parë në Lojërat e Mesdheut në Athinë (1991). Jeton në Shkup. (Lulzim Shala)

TËRSTENIKU. Fshat në Drenicë, rreth 5 km në veriperëndim të Drenasit, me lartësi mbidetare rreth 650 m. Është vendbanim i tipit të shpërndarë me sipërfaqe rreth 1,560 ha. Shtrihet pranë rrugës magjistrale Drenas-Skënderaj. Në regjistrimin kadastral osman të vitit 1455 dhe 1530, është i regjistruar me emrin Trestenik, ndërsa në sallnamet e Vilajetit të Kosovës të viteve 1893, 1896 dhe 1900 është i regjistruar me emrin Tërshenik. Nga viti 1912 e më vonë, shumë familje u shpërngulën për në Turqi dhe Shqipëri. Në vitin 1921 kishte 584 banorë, në vitin 1948 kishte 1,111 banorë, kurse në vitin 2011 u regjistruan 3,903 banorë. Veprimtari kryesore ekonomike është bujqësia. Ka edhe disa njësi tregtare, zejtare e shërbyese, si dhe fabrikën për prodhimin e miellit. Është bashkësi lokale, ku gravitojnë vendbanimet Polluzhë, Shtuticë dhe Vërboc. Ka dy shkolla 9-vjeçare, qendrën e mjekësisë familjare etj. (Ramiz Cërvadiku)

TËRSHANI Shaqir (1968-1999). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), dëshmor. Lindi në Greiçevc të Therandës. Në korrik të vitit 1998 u bashkua kompanisë së tretë të batalionit "Sadik Shala" të Brigadës 121 "Kumanova" të Zonës Operative të Pashtrikut,

në pikën e UÇK-së Qafa e Duhlës. Mori pjesë në shumë aksione luftarake dhe beteja, si në grykën e Carralevës, Budakovë, Greiçevc, Topillë, Llanisht, Reçak, Gurra e Kadijës, Kaçanik etj. U emërua komandant togu i njësitit vëzhgues-diversant, që vepronte në kuadër të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së. Më 15 janar 1999 mori pjesë në luftimet për mbrojtjen e Reçakut, ndërsa më 17 dhe 18 janar mbrojti fshatin Greiçevc dhe Rancë, në kuadër të mbrojtjes së trupave të masakrës së Reçakut, me qëllim që të mundësohej hetimi i pavarur ndërkombëtar. Më 10 maj 1999 u vra në fushëbetejë, në mbrojtje të popullatës së strehuar në malet e Llanishtit. (Ali Uka)

TËRTHORJA SHKODËR-PEJË. Paraqet një zonë (brez) të shkëputjes (thyerjes) tërthore shumëfazore të rendit të parë, me shtrirje në drejtim verilindje, përreth 100 km, e cila në territorin e Shqipërisë dhe të Kosovës ndan strukturën gjeologjike të Dinarideve (Albanideve veriore), në veriperëndim, nga struktura gjeologjike e Helenideve (Albanideve jugore), në juglindje. Konsiderohet një shkëputje, thyerje e thellë, tërthore e lashtë, e krijuar qysh në kohën e riftingut (riftëzimit) kontinental, duke funksionuar si shkëputje transformuese. Në terciar ka funksionuar si shtytje e djathtë në zonën ofiolitike të Mirditës dhe zonat e tjera, në drejtim të jugperëndimit për disa dhjetëra kilometra. Gjatë pliocen-kuaternarit është përpunuar (modifikuar) me shkëputje (thyerje) normale (gravitative), duke formuar fushëgropat tektonike të Tropojës dhe të Dukagjinit dhe duke paraqitur kështu një zonë aktive edhe sot. Zona e tërthores Shkodër-Pejë është një zonë aktive sizmike me potencial të pritshëm, me magnitudë maksimale 5.5. (Hashim Këpuska)

TËRRNAVA. Fshat në komunën e Preshevës. Shtrihet në dalje të lumit të Tërrnavës, nga ana e Karadakut. Në vitin 2002 fshati kishte 1,548 banorë rezidentë, shumica shqiptarë. Mbi fshat, në shpatet veriore të luginës së Rekës së Zezë (Lumit të Tërrnavës), ndodhet Shpella e Arushës, e cila është mjaft e pasur me ornamente. Pas Luftës së Dytë Botërore mbi fshatin Tërrnavë u hapën galeritë e minierës së kromit, ku u bë eksploatimi i kësaj xeheje për disa vjet. Mungesa e hulumtimeve për zbulimin e rezervave të reja çuan në

ndërprerjen e punëve minerare në fillim të viteve '60. Në fshat është aktive një gurore, nga e cila nxirret guri gëlqeror për ndërtimtari. Nga objektet e standardit shoqëror, fshati ka shkollën tetëvjeçare dhe ndonjë njësi shërbyese ose tregtare. (Arsim Ejupi)

TËRRNOCI. Fshat në komunën e Bujanocit, i njohur ndryshe edhe si Tërrnoci i Madh. Është vendbanim rural periurban i tipit të dendur. Shtrihet në kontaktin e shpateve lindore të zonës kodrinore-malore të Malësisë së Bujanocit në perëndim dhe fushës së Bujanocit në lindje, në lartësi mbidetare 423 m. Përmes fshatit kalon lumi i Tërrnocit, degë e majtë e Moravës Jugore. Gjetjet arkeologjike dëshmojnë për vendbanim të hershëm në afërsi të këtij fshati. Sipërfaqja e territorit të fshatit është 3,292 ha. Sipas të dhënave të regjistrimit të vitit 1961, Tërrnoci kishte 4,952 banorë, ndërsa në vitin 2002 kishte 8,893 banorë rezidentë. Një pjesë e konsiderueshme e banorëve të fshatit janë me punë të përkohshme në botën e jashtme. Është vendbanimi më i madh rural në Luginën e Preshevës, në Serbi dhe në mbarë hapësirat shqiptare. Ndërtimet e vazhdueshme të shtëpive, të cilat bëhen në të dyja anët e rrugës në drejtim të qytetit të Bujanocit, kanë bërë që fshati Tërrnoc të lidhet me qytetin e Bujanocit, me të cilin tanimë përbën një tërësi unike. Nga objektet e standardit shoqëror ka shkollën fillore 8-vjeçare, stacionin shëndetësor, shkretoren e plumbit (në kuadër të fabrikës "Svetlost" të Bujanocit), kopshtin e fëmijëve, shumë njësi tregtare e zejtare etj. Mbi fshat ndodhet edhe xeherorja e braktisur e antimonit, e cila ishte shfrytëzuar në periudhën 1939-1949. Tërrnoci është qendër e bashkësisë lokale për fshatrat Tërrnoc i Vogël, Konçul dhe Turi. (Arsim Ejupi)

TIFOJA E MORRIT. (*Typhus exanthematicus, epidemic typhus fever*). Është sëmundje akute ngjitëse, e cila fillon furishëm me temperaturë të lartë, ekzantemë të përgjithshme dhe shenja të intoksikimit të sistemit nervor. Shkaktar i sëmundjes është rikecia-Rickettsia Prowaseki. Sëmundja përhapet nga morrat e trupit, nuk përhapet nga njeriu te njeriu. Njihet që nga lashtësia si sëmundje e luftërave, kështu që në fillim të shekullit XIX, pas luftërave të Napolonit, tifoja kishte përfshirë pothuaj tërë Europën. Më pas një epidemi e tifos shfaqet gjatë luftërave

ruso-turke (1853-1856 dhe 1876-1878). Pas revolucionit rus nga tifoja e morrit sëmurën 30 milionë persona, nga të cilët 5 milionë vdesin. Gjatë Luftës së Parë Botërore nga tifoja e morrit besohet se kanë vdekur 800,000 njerëz. Në vitin 1946 në Kosovë pati mbi 20,000 të sëmurë, ndërsa në vitin 1945 raportohet për mbi 3,600 të vdekur. Gjatë periudhës 1945-1966 në Kosovë janë regjistruar 212,046 të sëmurë më 3,719 të vdekur. Sëmundja është zhdukur nga trevat shqiptare në vitet '60 të shekullit të kaluar. Sëmundja kryesisht paraqitet në vendet me klimë më të ftohtë dhe me kushte të ulëta higjienike, me një prani të shtuar të morrave të trupit. (Ariana Kalaveshi)

TIFOJA E ZORRËVE. (*Typhus Abdominalis*). Sëmundje akute ngjitëse, që karakterizohet me bakteremi dhe septikemi. Ndryshimet kryesore ndodhin në nyjat limfatike të zorrëve, ndërsa mekanizimi i përcjelljes së sëmundjes është fekal-oral. Zakonisht rastet janë të formës sporadike, por mund të paraqitet edhe në formë epidemike dhe endemike. Burim i infeksionit është njeriu i sëmurë ose si bartës. Ndjeshmëria ndaj sëmundjes është e përgjithshme. Edhe pse sëmundja paraqitet pothuajse në të gjitha shtetet, më e pranishme është në vendet e pazhvilluara, me kushte të ulëta higjienike-sanitare, më infrastrukturë të pazhvilluar dhe me nivel të ulët të kulturës higjienike. Kosova në të kaluarën ka pasur një situatë epidemiologjike tejet të pasigurt me këtë sëmundje. Rastet paraqiteshin në formë sporadike, por edhe në formë të epidemive të vogla familjare. Gjatë dekadave të fundit, në Kosovë janë regjistruar mbi 30 epidemi të kësaj sëmundjeje. Është e njohur epidemia e vitit 1962 në Prishtinë, me 1,716 të sëmurë dhe 8 të vdekur. Në dhjetëvjetëshin e fundit janë regjistruar dy epidemi hidrike masive: në Tunelin e Parë në Mitrovicë në vitin 1984, me 134 të sëmurë dhe në Shtime, me 84 të sëmurë në dhjetor të vitit 1993 dhe janar-shkurt të vitit 1994. Në dekadën e kaluar në Kosovë janë regjistruar 734 persona të sëmurë, me shkallë të lartë mesatare të morbiditetit prej 4.17 në 100,000 banorë. Nga viti 2006 deri në vitin 2014, në Kosovë janë raportuar 110 raste me shkallë mesatare të kësaj sëmundjeje (0.64 në 100,000 banorë). Numër pak më i lartë është raportuar në vitet 2008 (29 raste) dhe 2006 (24 raste). (Ariana Kalaveshi)

TIMAK MINUSI. Vendbanim antik që gjendej në skajin verior të Dardanisë, në fshatin Ravnë, në rrjedhën e epërme të Timokut, përkatësisht të Timokut të Bardhë, në veri të Knjazhevcit. Është shënuar si stacion në rrugën antike Naissus-Ratiaria dhe paraqet vendbanim të madh të karakterit kanabe (canabae), i cili u zhvillua pranë kastelit të gjysmës së dytë të shek. I, të rindërtuar në mesin e shek. II. Në të u stacionua Kohorta Aureliane Dardane II, e cila, sipas karakterit dhe rëndësisë ushtarake, gjendej në të njëjtin nivel me kampet e mëdha ushtarake në Danub. Shtrihej në kufirin e territoreve të Naisit dhe Raciars dhe përbënte një njësi territoriale të pavarur. Edhe pse është pak i njohur organizimi i tij, ishte një ndër ndërtimet më të rëndësishme civile të sektorit të Timokut të Epërm, i pasur me resurse natyrore, si dhe qendra e tij administrative e shek. II-IV. Depot e mbetjeve të përpunimit të metaleve të zbuluara në jug flasin për lidhjen që ka ekzistuar ndërmjet Ravnës dhe aktivitetit xehetar në këtë pjesë të luginës së Timokut. Si e tillë përbënte aglomeracion që kishte për funksion kryesor udhëheqjen dhe kontrollin e minierave (vicus metalli), duke qenë dhe seli e zyrës së prefektit të territorit. Territori fiskal i aglomeracionit përfshinte jugun e skajshëm të pronës së gjerë perandorake, që kapte gati krejt luginën e Timokut, res metallica e së cilës përbënte bazën ekonomike. Për shkak të popullsisë dardane, krahina bënte pjesë në Metalli Dardanici. Në jug prekte territorin municipal të Naisit dhe distriktin xeheror të Remesianës, në lindje metalla të territorit të Montanës, ndërsa në veri dhe veriperëndim shtrihej deri te minierat e luginës së Timokut të Zi. (Exhlale Dobruna-Salihu)

TIVARASI Miho (shek.XIV). Skulptor dhe arkitekt mesjetar. Me siguri i lindur në Tivar, meqë në çdo dokument të zyrës raguzane, ku zihet ngoje ky skulptor dhe arkitekt, përmendet edhe qyteti i tij i lindjes. Veprat kryesore e Tivarasit janë mungada e Kuvendit Françeskan në Raguzë, si dhe disa skulptura në Kishën e Manastirit të Deçanit (1327-1335). Krijimtaria e Tivarasit në Kishën e Manastirit të Deçanit provohet edhe nga stili i tij karakteristik. Sipas studiuesit gjerman të historisë së arteve, R. E. von Edelberger (1884), “mungada e M. Tivarasit është monumenti më interesant i ruajtur në Dubrovnik”. Ndërkaq,

ngjashmëritë e stilit të tij në Raguzë dhe Deçan i vërejtën disa studiues të historisë së arteve. M. Tivarasin e ndeshim edhe në studimin mbi zhvillimin e arteve në bregdetin lindor të Adriatikut, të britanikut, T. G. Jackson (1887), i cili flet për origjinën e tij arbërore (*Master Mycha, an Albanian of Antivari*). Mungada dhe pjesë nga arkitektura dhe skulptura e Kishës së Manastirit të Deçanit, për nga stili janë përpjekje për avancimin praktik të artit romanik në atë gotik. Për model të kluastrit të Kuvendit Françeskan në Raguzë dhe të kishës së Manastirit të Deçanit, M. Tivarasi mori elemente romanike nga Italia dhe Franca, por gjithnjë duke ofruar freski me elemente të reja gotike, stil që atëbotë kishte filluar të përhapej edhe në pjesët lindore të Adriatikut dhe prej këtej edhe në Kishën e Manastirit të Deçanit. (Jahja Drançolli)

TIVARI. Qytet bregdetar në jug të Malit të Zi të sotëm. Në mesjetë e ndeshim me emrat: Antibari, Antivari, Antivarion etj. Emri i tij është i lidhur me emrin e qytetit të Barit në



KALAJA E TIVARIT

Itali, i cili gjendet në anën e përtejme të detit Adriatik. Materialet e gjetura dëshmojnë se në Tivar ka prezencë të kulturës dhe dëshmive etnografike, linguistike e onomastike që nga periudha ilire, ndërsa konsiderohet pikë e rëndësishme strategjike që në kohën e pushtimit romak. Tivari paraqitet si vendbanim me rëndësi gjatë tërë mesjetës. Ishte pjesë e fortifikimeve dhe rrugëve të periudhës romake dhe mesjetare. “Via de Zenta”, që vazhdonte drejt hinterlandit arbëror, vazhdon të jetë e qarkullueshme gjatë tërë mesjetës, ndërsa më vonë paraqitet si arterie me rëndësi për lidhjet tregtare, sidomos me miniera të pasura në

Kosovë. Bujaria tivarase kishte marrëdhënie të mira me qendrat e njohura të Adriatikut. Qyteti kishte pozitë të mirë gjeostrategjike. Vija e fortifikimeve shkonte nga Tivari, përkatësisht nga Lezha, përgjatë Drinit dhe përskaaj rrugës së dikurshme romake, e cila gjatë mesjetës kishte shtrirje edhe deri në Shëngjin e Durrës, për t'u lidhur me qytete të tjera arbërore dhe bizantine. Nga koha e perandorit Anastasi, përveç Durrësit, si pikëmbështetje e pushtetit bizantin në Arbëri ishin Tivari, Shkodra, Lezha, Kruja dhe ndonjë tjetër, mbrojtja e të cilave u ishte besuar komandantëve vendës. Qyteti u zhvillua nga kështjella bizantine Antipargai, të cilën historiani Prokopi e përmend ndër fortesat, të cilat i ka rindërtuar perandori Justinian (527-565) në kushtet e presionit të fortë nga sulmet barbare.

Argjipeshkvia e Tivarit (1089) u bë pikëmbështetje kryesore e organizimit kishtar në Ballkan, nëpërmjet së cilës kuria romane komunikonte edhe me pjesë të hinterlandit arbëror. Përveç rolit të organizimit kishtar me kisha vartëse të saj, ajo ishte përfaqësuese me rëndësi e krishterimit në raport me Romën. Nga shekujt e parë të ekzistencës, Antibarum ishte në objektivin e interesave të vendeve të fuqishme dhe sundimtarëve rajonalë. Ishte pjesë e Themës së Durrësit deri më 989 dhe Argjipeshkvisë së Durrësit deri më 1022, ndërsa nga mesi i shekullit XI hyn në përbërje të shtetit të Dioklesë. Gjatë viteve '60 të shek. XII, pjesët bregdetare të Dioklesë, së bashku me Tivarin, sërish i bashkëngjiten Bizantit. Më 1183 e pushton Stefan Nemanja, ndërsa në përbërje të shtetit të Rashës, Tivari mbeti deri në vdekje të Stefan Dushanit (1355). Tivari nga vitet '60 të shek. XIV u administrua nga shteti i Balshajve, të cilët aty kishin oborrin e tyre, deri në vdekje të Balshës III më 1421. Pas këtij viti Venediku e pushtoi Tivarin për të dytën herë, por vetëm për pak kohë, sepse qyteti sërish edhe për dy dekada ra nën sundimin e despotit Stefan Lazareviq. Aty ishte edhe selia e Mazarekut, dukës së Zetës dhe trashëguesve të tij. Nga shtatori i viti 1442 deri në maj të vitit 1443, Tivari u ekspozua rrethimit venedikas. Mbrojtësit e fundit kishin lëshuar kalanë e Tivarit më 4 qershor, me ç'rast nisi sundimi i tretë i venedikasve, që vazhdoi deri në vitin 1571, kur e pushuan osmanët. Në sajë të zhvillimit të tregtisë dhe detarisë gjatë

shek. XVIII, Tivari ishte ndër portet më të rëndësishme të Bushatlinjve. Në fund të tetorit të viti 1877 u rrethua nga forcat malazeze dhe, pas një qëndrese tremujore, u shkatërrua tërësisht kështjella dhe u pushtua më 10 janar 1878, me ç'rast u ndryshua edhe struktura e popullsisë. Pjesa më e madhe e popullsisë shqiptare detyrohet të mërgojë dhe qyteti filloi të kolonizohet. (Faik Sahiti)

TJERRTORJA. Lokaliteti parahistorik i epokës së neolitit. U zbulua rastësisht gjatë ndërtimit të fabrikës së pambukut "Tjerrtorja" në Prishtinë, lagjeja e Kalabrisë (dikur Emshir). Ndër objektet më të njohura të lokalitetit është "Hyjnesha në fron". Në pikëpamje stratigrafiko-kulturore ndahet në dy periudha kronologjike të lidhura me kulturën e Vinçës, rrjedhimisht me fazat Vinça-Tordosh I-II dhe Vinça-Plloçnik I të variantit moravo-jugor kosovar. Zbukurimi i qeramikës është bërë me anë të incizimit, me motive meandrash të rregullt e të parregullt, të ngjashme me ato të qeramikës të kulturës së Vinçës nga Vinça, Gradaci dhe Plloçniku. Në qeramikën dhe plastikën e vendbanimit janë gjetur dhe zbukurime me lyerje të hapësirave midis motiveve me ngjyrë të kuqe që fshihet, karakteristikë për fundin e kulturës së Vinçës.

Në vendbanim janë ndeshur dhe disa veçori specifike lokale, gjë që e dallojnë prej atij të grupit të Vinçës. Kështu, në qeramikën e incizuar shfaqet teknika e re e incizimit të ornamenteve përmes shiritave të mbushur me vija të shkurtra me origjinë nga Adriatiku (kultura Danilo III-IV). Disa motive të tilla shfaqen edhe në Novi Pazar dhe janë të panjohura për vetë kulturën e Vinçës. Si shfaqje lokale konsiderohen edhe prirjet realiste të trajtimit të plastikës monumentale, siç është ajo e figurës shtazore me kokë njeriu, e njohur edhe nga vendbanimi fqinj i Vallaçit, ai i kokës së gjarprit etj. Këto veçori lokale kulturore i kanë shtyrë studiuesit për ta parë kulturën e kësaj faze në rrafshin e Kosovës si variant moravo-jugor i zhvilluar i kulturës së Vinçës. Lokaliteti u gërmua në vitet 1950-1951 dhe 1955-1956 nga Muzeu i Kosovës. (Sedat Barajliu)

TMAVA Ahmet (1962-). Inxhinier i gjeologjisë, profesor universiteti. Lindi në fshatin Shipol të Mitrovicës. Shkollimin fillor dhe të mesëm

i mbaroi në Mitrovicë, studimet nga fusha e gjeologjisë i kreu në Fakultetin e Xehetarisë dhe të Metalurgjisë të Universitetit të Prishtinës (1987). Po atë vit filloi punën si asistent në këtë fakultet, ndërsa në vitin 2013 merr titullin profesor i rregullt. Studimet pasuniversitare i mbaroi në Tiranë, ku mbrojti edhe disertacionin (2003). Në periudhën 2010-2014 kryesoi bordin e Komisionit të Pavarur të Minierave dhe të Mineraleve. Është autor dhe bashkautor i një sërë punimesh profesionale e shkencore të publikuara në revistat dhe në përmbledhje nga kongrese, simpoziume dhe konferenca të mbajtura brenda dhe jashtë vendit. Është autor i disa projekteve nga fusha e gjeologjisë, e minierave dhe e mjedisit. Aktualisht është menaxher i “Trepçës”. (Izet Zeqiri)

TOÇI Zef (1941-). Pikturor. Lindi në Mitrovicë. Kur ishte fëmijë, familja e tij u vendos në Prizren, ku më pas kreu filloren dhe gjimnazin. Në Prishtinë kreu Shkollën e Lartë Pedagogjike, degën e artit figurativ, ndërsa në Bruksel Akademinë Mbretërore të Arteve të Bukura (1972), ku u dekorua me çmimin “Medalja e argjendtë”. Mbaroi studimet pasuniversitare në Fakultetin e Arteve në Beograd më 1981. Në fillim punoi në Normalen e Prizrenit (1967-1971), më vonë në kombinatin e tekstitit “Printeks”, si kreator i tekstileve (1972-1975), kurse gjatë viteve 1975-1978 në Akademinë Pedagogjike si profesor i artit figurativ. Nga viti 1982 deri në pensionim punoi në shkollën e mesme ekonomike-juridike në Prizren. Si anëtar i Shoqatës së Artistëve Figurativë të Kosovës mori pjesë në ekspozita kolektive brenda dhe jashtë vendit. Hapi disa ekspozita personale: në Prizren (1968, 1996), Opati (1968), Beograd (1969) dhe Prishtinë (1972, 2005, 2010). Në pikturat e tij dominojnë trajtat e natyrës së qetë, me shprehje poentilike dhe mbireale. Portretet, peizazhet dhe kompozicionet i shquan harmonia tonale me aksente të veçanta. (Rexhep Goçi)

TODOROVIQ Jovan (Todorović) (?-). Arkeolog serb, keltolog. Lindi në Maqedoni. Studimet për arkeologji i kreu në Universitetin e Beogradit, ku edhe doktoroi. Ishte njëri ndër keltologët e rrallë në territorin e ish-Jugosllavisë dhe botoi disa libra lidhur me fazën latene. Për një kohë të gjatë ishte drejtor i Muzeut të Qytetit të Beogradit. Në Kosovë bëri

gërmime arkeologjike në Hisar të Suharekës (1961-1963), Reshtan të Suharekës (1963), si dhe bashkëgërmoi në nekropolin tumular të Romajës, që rezultoi me botimin e librit “Romaja parahistorike”. Ishte këshilltar shkencor dhe pjesëmarrës në hulumtimet arkeologjike në lokalitetin e Vërmicës te Prizreni. Gjithashtu dha kontribut për themelimin e Muzeut Arkeologjik të Prizrenit. (Edi Shukriu)

TOKA BUJQËSORE. Territori i Kosovës karakterizohet me përbërje mjaft heterogjene të tipave pedologjikë të tokës. Më të përhapura (47.0%) janë toka ngjyrë kafeje - kambike (distrike dhe eutrike), toka silikatore (rankere) rreth 11.2%, smonica-vertisole rreth 10.0%, aluviale-fluvisole rreth 7.7%, deluviale-koluviale rreth 6.4%, gurore-litosole 3.8% dhe humusore akumulative-rendzina rreth 2.4%. Tokat kambike kanë strukturë stabile dhe raport të volitshëm ujor-ajror. Kanë reaksion të dobët acidik deri neutral, me përmbajtje humusi 2-3%. Këto toka janë mjaft të përshtatshme për prodhimtari bujqësore, si drithërat, perimet, bimët industriale, pemët, hardhitë. Më të përhapura janë në zonat e Prishtinës, Podujevës, Leposaviqit, Gjilanit, Zubin Potokut dhe Kamenicës. Tokat smonicë-vertisole janë toka të rënda-argjilore, në të cilat dominon minerali i montmorilonitit. Vetitë fizike janë të papërshtatshme, kanë plasticitet, përshkueshmëri dhe rezistencë të lartë gjatë punimit, me periudhë të shkurtër të pjekurisë fizike për punim. Përmbajnë 3-5% humus me kapacitet të lartë të absorbimit. Reaksioni është i dobët acidik, neutral, deri i dobët alkalik. Kanë vlerë të rëndësishme prodhuese dhe kryesisht shfrytëzohen për prodhim të drithërave. Më të përhapura janë në zonat e komunave të Lipjanit, Rahovecit, Vushtrrisë, Kamenicës, Gjilanit, Drenasit, Ferizajt dhe Prishtinës. Tokat aluviale-fluvisole janë toka të thella me përshkueshmëri shumë të përshtatshme për ujë. Janë toka neutrale me përmbajtje mesatare të lëndës organike. Këto toka nuk kanë kufizime për prodhimtari bujqësore dhe kryesisht shfrytëzohen për kultivim të kulturave lavërtare dhe perimore. Më të përhapura janë në komunat Deçan, Vushtrri dhe Podujevë. (Xhevdet Elezi)

TOKAT. Pjesa e shkrifët e sipërfaqes së Tokës, e cila shfrytëzohet për kultivimin e kulturave

bujqësore. Tokat si produkt varen nga ndërtimi gjeologjik, relievi, kushtet klimatike, hidrografike si dhe bimësia. Elementet kryesore të relievit të territorit të Kosovës janë formuar në periudhën e oligomiocenit. Ekzistojnë tri formacione të relievit: a) rrafshinat e lumenjve; b) pjesët më të larta që rrethojnë rrafshinat me reliev malor, me disa rrafshina të vogla apo të mëdha; c) pjesët e larta, që rrethojnë nga të gjitha anët territorin e Kosovës, me reliev bregor-malor. Substratet amë të formimit të tokave të territorit të Kosovës janë shkëmbinjtë me origjinë sedimentare (66%, nga të cilët 60% janë të shkrifët, derisa 40% shkëmbinj sedimentarë të fortë), metamorfe (19%) dhe magmatike (14%). Tokat e territorit të Kosovës kanë filluar të studiohen që nga vitet '20 të shekullit XX. Është punuar harta pedologjike e Kosovës me shkallë 1:50,000, ku janë paraqitur llojet e tokave, të përfaqësuara nga 13 tipa kryesore të ndara në 8 klasa bonitative. Tipat kryesorë: 1) aluvijum (101,410 ha ose 9.3%); 2) deluvijum (49,656 ha ose 4.6%); 3) livadhore (12,342 ha ose 1.1%); 4) minerale-moçalike të aglejuara (5,079 ha ose 0.5%); 5) smonicë (109,446 ha ose 10%); 6) e murrme argjilore të liqeneve (14,080 ha ose 1.3%); 7) e kuqërremtë e murrme (133,160 ha ose 12.2%); 8) pseudoglej (37,531 ha ose 3.4%); 9) rendzinë (111,940 ha ose 10.3%); 10) e kafenjtë mbi shkëmbinj kompaktë (324,207 ha ose 29.8%); 11) e kuqe (41,000 ha ose 3.8%); 12) ranker (119,967 ha ose 11%); 13) litosole (28,880 ha ose 2.7%). Të gjithë tipat dhe nëntipat e tokave të territorit të Kosovës, për nga cilësia produktive, janë të sistemuara në 8 klasa bonitative. Sipërfaqet e përgjithshme me nënklasat bonitative I – V përfshijnë rreth 455,000 ha (41.8 %), si të përshtatshme për kultivim, në kuadër të të cilave vetëm 396,580 ha konsiderohen si sipërfaqe bujqësore, ndërsa 252,500 ha si tokë për kultivim të bimëve të arave dhe si livadhe. Rreth 144,000 ha janë të okupuara dhe përdoren për qëllime të tjera. Pjesa tjetër prej 694,400 ha (63.4%) u takojnë klasave VI-VIII. Por edhe në kuadër të këtyre klasave shfrytëzohen rreth 107,000 ha si toka të punueshme, të cilat kanë produktivitet të ulët. Tokat e klasës V dhe VI kërkojnë ndërmarrjen e masave përkatëse meliorative për t'ua rritur prodhimin. Sipërfaqet e tërë territorit të Kosovës për nga mundësitë dhe përshtatshmëria e tokës, klimës, lartësisë

mbidetare dhe pozitës për prodhimtari përkatëse (si kritere), janë të ndara në 10 rajone, që do të thotë se është bërë rajonizimi i prodhimtarisë bimore. Në Kosovë dy herë janë hapur sipërfaqe të reja punuese në përmasa të mëdha nga shteti, me shpyllëzim të sipërfaqeve të valëzuara dhe të atyre të rrafshëta, të cilat kanë qenë nën pyje të ulëta (dushkajat), të shkurreve, lëndinave etj. Herën e parë kjo është bërë gjatë viteve 1920-1925, në sipërfaqe prej 25,000 ha (për kolonët serbë) dhe herën e dytë gjatë viteve 1957-1962, në sipërfaqe prej 27,000 ha (për sektorin shoqëror). Hulumtimet e deritanishme tregojnë se ekzistojnë edhe rreth 30,000-35,000 ha të mundshme për hapje të sipërfaqeve të reja. (Bashkim Kabashi)

TOMEIO Leonik Nikollë (1456-1531). Humanist, filozof, letrar, historian. I ati lindi në Arbëri dhe është shpërngulur nga atdheu në kohën e sulmeve osmane dhe është vendosur në Venedik (shek. XV). Shumë studiues mendojnë se origjina e familjës së Tomeut është nga zona bregdetare e Arbërisë, përkatësisht nga Durrësi ose Shkodra. Vitet e fëmijërisë së bashku më vëllezërit e tij i kaloi në Venedik dhe në Padova. Së pari kishte studiuar greqishten në Padova, pastaj në Firence e Milano. Veprimtaria e tij është shtrirë në fusha të ndryshme, në filozofi, histori, mjekësi, fizikë, astronomi, matematikë e letërsi. Veprat kryesore të tij janë: "Histori të ndryshme në tre libra" (De varia historia libri tres, 1531); "Dialogët" (Dialogi, 1524) etj. Pos veprave origjinale dhe shumë përkthimeve, Tomeu shkroi edhe poezi sipas modelit të Petrarkës, kushtuar personaliteteve të shquara të kohës. Ndryshe nga veprat e tij të njohura, si dhe korrespondencat me burrat e mëdhenj të kohës, të cilat i shkroi në gjuhën latine e greke, vargjet i shkroi në gjuhën italiane e latine. Opusi poetik i tij qe lavdëruar nga P. Bembo (1470-1547), G. Tiraboschi etj. Edhe pse zotëronte pasuri të madhe në Padovë, Tomeu qe i lidhur ngushtësisht me studime. Senati i Venedikut e kishte emëruar të ligjëronte në Universitetin e Padovës tekste greke të Aristotelit, si dhe për profesor të filozofisë dhe mjekësisë (1497), të cilin e braktisi për të ligjëruar letërsinë greke e latine në Katedrën e Rialtos në Venedik (1504). Edhe pas këtij emërimi këtu për ligjërues, Tomeun e ndeshim edhe në jetën publike dhe universitare të Padovës, ku dhe vdiq më 1531. Nga disa faqe të një dorëshkrimi të

Tomeut, i cili konsiderohet për dorëshkrim autobiografik, dëshmohej emri i Benediktit (Benedetto), njëri ndër vëllezërit e tij, autor i një traktati që trajton çështjen e shpirtrave të rebeluar dhe të burimit të mëkatit e të “Fjalës hyjnore”. Përveç tij përmendet edhe një vëlla tjetër i quajtur Bartolomeo, i njohur me një poemë të publikuar në gjuhën latine (1558). (Jahja Drançolli)

TOMIQ (Tomić) Edmond (1956-). Futbollist. Lindi në Prizren. I takon brezit të futbollistëve të KF “Liria” të Prizrenit, kur ajo ishte ndër skuadrat më cilësor të ligës së dytë të ish-Jugosllavisë. Nisi karrierën në Prizren, ndërsa për skuadrën e parë luajti gjithsej 95 ndeshje (1975-1978). Karrierën e vazhdoi te KF “Rijeka”, ku luajti plot shtatë vjet (1978-1984). Te “Rijeka”, që bënte pjesë në ligën e parë të ish-Jugosllavisë, luajti 129 ndeshje. Më pas vazhdoi karrierën në futbollin ndërkombëtar. Gjatë periudhës 1985-1987 luajti në Austri, për SV “Spittal/Drau”, ndërsa dy vjet ishte pjesë e FC “Salzburg” (1988-1989), ku edhe e mbylli karrierën aktive. (Vllaznim Bytyçi)

TOMIQ (Tomić) Jezdimir (1930-). Aktor. Lindi në Prizren, ku e mbaroi shkollën fillore dhe të mesme. Prej vitit 1948 u bë anëtar i Dramës Serbe në Teatrit Popullor Krahinor (TPK), ku deri në vitin 1981 realizoi shumë role. Shquhej për aktrim organik dhe të natyrshëm. Me sukses aktroi role kryesore dhe dytësore. Për një kohë të gjatë u konsiderua njëri nga aktorët më të mirë të Dramës Serbe në TPK. Nga shfaqjet e realizuara në skenën e TPK-së mund të veçohen: “Personi i dyshimtë”, “Karriga që luhetet”, “Hoteli për të çmendur”, “Oskar”, “Dundo Maroje”, “Strofulli i ujkut”, “Karriga që luhetet”, “Intrigë e dashuri” etj. (Fadil Hysaj)

TOPALLI Demë (1948-). Shkrimtar. Lindi në Llugë të Istogut. Shkollën fillore e kreu në Vrellë, gjimnazin në Istog, ndërsa studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Pak kohë punoi si mësimsdhënës në shkollat e Istogut dhe të Prishtinës, pastaj u punësua në ndërmarrjen “Rilindja”, ku një kohë të gjatë kreu punën e lektorit e të redaktorit në revistat e “Rilindjes”. Nga fillimi i viteve ‘90 e këtej kryen punën e drejtorit të revistave. Me krijimtari letrare është marrë që nga moshja e re, kryesisht me poezi.

Poezitë e para i ka botuar te revistat “Jeta e re” e pastaj te “Fjala”, “Rilindja” etj. Deri tani ka botuar këto vepra: “Vera e ikur” (1972), “Druri i fatit” (1978), “Haber i mirë” (1991), “Sytë që dinë me pa” (2016). Merret edhe me përkthime letrare, eseistike dhe teorike, të cilat janë botuar kryesisht në revista letrare dhe gazeta të vendit. Spikat përkthimi i librit të Linda Hutcheon: “Poetika e posmodernizmit. Historia, Teoria, Fiksioni” (2013). Drejton revistat letrare “Pionieri” dhe “Jeta e re”. (Munish Hyseni)

TOPALLI Kolec (1938-). Gjuhëtar, profesor, akademik. Lindi në Shkodër, ku mbaroi shkollimin fillor dhe të mesëm. U diplomua në Universitetin e Tiranës për gjuhë dhe letërsi shqipe. Përgatiti dy disertacione, një më 1986 dhe një më 1992. Punoi mësues në rrethet e Kukësit, të Lezhës, të Gramshit e të Krujës. Botimet e para studimore i bëri që në vitet shtatëdhjetë, por me intensitet të shtuar u shfaq



KOLEC TOPALLI

pas rënies së monizmit në Shqipëri. Është një ndër autorët më produktivë shqiptarë. Interesimet e tij janë në fushën e historisë së gjuhës. Në fushën e fonetikës historike shkroi monografi për theksin e shqipes, për diftongjet, për sonantet, për mbylltoret, për fërkimoret e për afrikatat, për hundorësinë, për shndërrimet historike të sistemin e zanoreve të shqipes, për dukuritë fonetike të sistemit bashkëtingëllor të shqipes. Në sferën e gramatikës historike shkroi për përemrat dhe zhvillimin e tyre historik në shqipen, për nyjat e shqipes, për sistemin rasor. Kërkimet e tij në fushën e fonetikës historike i përmbylli me veprën voluminoze “Fonetika historike e gjuhës shqipe” (2005), ndërsa ato të gramatikës historike me veprën “Gramatika historike e gjuhës shqipe” (2012). Përgatiti për shtyp edhe fjalorin etimologjik të gjuhës shqipe me mbi tridhjetë mijë fjalë. Monografinë e parë e ka publikuar më 1995. Monografia e tij për theksin është publikuar edhe në Itali. Është fitues i disa çmimeve kombëtare për kontributet në albanologji, përfshirë “Çmimi i albanologjisë” (2008) dhe “Mësues i popullit” (1993). Ishte sekretar i përgjithshëm i Presidentit të Republikës (1992-1997) dhe këshilltar në Ambasadën e Shqipërisë në Itali

(2006-2007). Punoi si punonjës shkencor në Institutin e Gjuhësisë e të Letërsisë, ku vazhdon të jetë në cilësinë e koordinatorit shkencor. Mban titullin e profesorit që nga viti 1994, ndërsa ka mbajtur lëndën e fonetikës historike të gjuhës shqipe në Universitetin e Tiranës. Është anëtar i Këshillit Ndërkademiç për Gjuhën Shqipe. Më 2008 është zgjedhur anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Është anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. (Bardh Rugova)

TOPALLI Enver (1959-1998). Veprimtar, i burgosur politik, dëshmor. Lindi në fshatin Greme-Topojan të Ferizajt. Kreu shkollimin e mesëm në Ferizaj, studimet për ekonomi i



ENVER TOPALLI

vazhdoi në Universitetin e Prishtinës. Më 1979 u arrestua për veprimtari ilegale. Në vitin 1982 emigroi në Zvicër. Në Byl të Friburgut (Zvicër) themeloi klubin "Shotë Galica". Në vitin 1983 u kthye në Kosovë, u arrestua për herë të dytë, më pas u lirua, por u arrestua prapë për herë të tretë më 1984 dhe me akuzën "bashkim për veprimtari armiqësor" u dënua me 14 vjet burg. Pas amnistisë, u lirua nga burgu në korrik të vitit 1991. U bë anëtar aktiv i Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (1991) dhe i Kryesisë së degës së Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) në Ferizaj. Në zgjedhjet e majit të vitit 1992, të organizuara nga LDK-ja, u zgjodh deputet i Parlamentit të Kosovës. Më 25 qershor 1998 u arrestua nga policia serbe për veprimtari në lidhje me organizimin e UÇK-së dhe u dënua me 15 vjet burg. Më 19 maj 1999 u ekzekutua nga forcat serbe në burgun e Dubravës. (Ruzhdi Jashari)

TOPÇIU Vedita (1935-). Lindi në Prizren. Shkollën fillore e përfundoi në Prizren, ndërsa shkollën normale në Gjakovë. Është diplomuar dhe ka kryer studimet pasuniversitare në Fakultetin Filozofik të Prishtinës (1979). Ka punuar mësimdhënëse në shkollë të mesme në Prizren, ndërsa më 1979 është zgjedhur ligjëruese e gjuhës shqipe në degët e gjuhëve të huaja në Fakultetin e Filologjisë. U pensionua më 1991. Ka hartuar si bashkautore gramatikën e gjuhës shqipe për klasat e pesta. Ka publikuar

artikuj studimorë që kryesisht lidhen me kontaktet e shqipes me turqishten në Kosovë. (Bardh Rugova)

TOPLICA Avni (1951-). Skulptor. Lindi në Prishtinë. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Prishtinë. Është anëtar i Shoqatës së Artistëve Figurativë të Kosovës (SHAFK) nga viti 1983. Punon kryesisht në metal. Mori pjesë në disa ekspozita kolektive dhe organizoi dy ekspozita personale: më 1974 në Shtëpinë e Armatës në Prishtinë dhe më 1986 në Galerinë "Rada" në Prizren, pastaj në ekspozitat kolektive të organizuara nga SHAFK-u: Salloni Pranveror, Bienalja e Vizatimit, Salloni Vjeshtor si dhe disa ekspozita ndërkombëtare. Trajton motive kosovare, ndërsa në realizimet e tij skulpturale dominon fryma ekspresivo-surreale dhe abstrakte e sferave dhe formave në kombinim materialesh, dru dhe metal. Është fitues i çmimit për skulpturë në Sallonin e Nëntorit në Prishtinë (2011), i çmimit për grafikë "Penda e Artë" në Zagreb (1989), i çmimit për skulpturë në Sallonin e Rinisë në Prishtinë (1985) etj. (Luan Mulliqi)

TOPLICA. Krahinë e veçantë në Ballkanin Qendror, që sot gjendet në Serbinë e Jugut. Shtrihet në luginën e lumit me të njëjtin emër dhe të degëve të tij. Në të tri anët është e rrethuar me male: në perëndim me Kopaonikun, në veri me Jastrebcin e në jug dhe jugperëndim me Vidojevicën, Sokollovicën dhe Pasaçën. Në lindje të Toplicës shtrihet lugina e Moravës Jugore, afër Nishit. Degë e lumit të Toplicës, e rrjedhës së saj të epërme, është Kosanica, e cila derdhet në Toplicë afër Kurshumlisë. Kosanica është lidhja kryesore komunikuese midis krahinës së Toplicës dhe basenit të Kosovës, rrjedhimisht midis hapësirës së sotme të Toplicës dhe territorit aktual të Kosovës.

Kushtet e përshtatshme natyrore-gjeografike, si relievi kodrinor-malor, rrafshi luginor, toka pjellore, pasuritë xehtare, burimet e shumta termale dhe minerale etj., ishin të përshtatshme për jetë të bashkësive popullative parahistorike në fazën e popullimit themelor, duke formuar edhe vendbanimet e para në këtë trevë. Sipas gjetjeve arkeologjike dhe burimeve të shkruara, deri në fillim të shek. III para epokës sonë territori i Toplicës me rrethinë ishte i mbuluar me ndërtesa dhe fortifikata ushtarake dhe civile romake. Në antikë kjo krahinë i takonte

provincës romake të Mezisë së Ulët, më vonë Dardanisë. Që nga lashtësia, territori i Toplicës ishte vatër e gërshetimit të civilizimeve dhe e lëvizjeve të ndryshme historike e politike, etnike e kulturore. Gjatë periudhës së sundimit osman, Toplica (Prokupla) ishte njëra ndër katër qarqet e Sanxhakut të Nishit, në kuadër të Vilajetit të Kosovës. Me 3,679 km² përfshinte 33.52% të territorit të këtij Sanxhaku dhe ishte qarku më i madh i tij. Prokupla që nga fundi i shekullit XIX bëhet qendër e krahinës së Toplicës dhe deri në luftën serbo-turke dhe Krizën Lindore (1878), Prokupla me rrethinë ishte e banuar me shqiptarë, që përbënin shumicën e popullsisë. Kishte edhe turq dhe çerkezë.

Pas vitit 1878, Serbia bëri një spastrim etnik të përmasave të gjëra, duke ushtruar represalie dhe duke dëbuar me dhunë të gjithë shqiptarët dhe bashkësitë myslimane nga Prokupla me rrethinë (Toplica, Kosanica, Dobriqi, Pusta Reka), nga rrethi i Vranjës dhe Leskovcit (Polanica, Jabllanica, Veternica, Masurica, Surdulica), pastaj Nishi me rrethinë, përfshirë edhe Pirotin dhe Bella Pallankën. Të dëbuarit shqiptarë nga Toplica dhe viset e tjera, të njohur si muhaxhirë, u vendosën në Kosovë, në Luginën e Preshevës, në Maqedoni dhe një numër i tyre edhe në Turqi. Prokupla mbeti qendër e Toplicës edhe pas Luftës së Dytë Botërore, ndërsa sipas regjistrimit të vitit 2002 në qytet dhe komunë nuk jeton më asnjë shqiptar. (Hivzi Islami)

TOPLLUHA. Lumë në Rrafshin Dukagjinit, degë e majtë e Drinit të Bardhë, rrjedh në pjesën juglindore të Rrafshit të Dukagjinit. Pjesa burimore gjendet në afërsi të kyçit hidrografik të Gadishullit Ballkanik (Sukës së Dermanit, 1,364 m). Është lumë tipik fushor. Për shkak të pjerrësisë së vogël, në pjesën e poshtme të tij ka krijuar disa mendra të vogla. Pellgu i Toplluhës ka sipërfaqe rreth 504 km² dhe, për nga madhësia, është pellgu i dytë më i madh i Drinit të Bardhë, pas Erenikut. Sasia mesatare e reshjeve në pellg është 781 mm, rreth gjysma e tyre avullohen, kurse pjesa tjetër rrjedh dhe infiltrohet. Moduli i rrjedhjes është 7.9 l/s/km². Prurja mesatare rreth 4 m³/sek. Në grykëderdhje ka prurje jo të barabartë gjatë vitit. Sasia më e madhe e ujit rrjedh në muajt e parë të vitit dhe në dhjetor, që tregon se prurja varet më tepër nga reshjet e shiut sesa

të borës (regjim pluvio-nival). Degët më të rëndësishme të këtij lumi janë: lumi i Leshanit, Korishës, Opterushës, Semetishtit, Drakaçinës etj. Degët që burojnë dhe rrjedhin prej Malit të Sharrit kanë prurje më të madhe dhe varen nga shkrirja e borës, kurse degët veriore dhe lindore kanë prurje më të vogël. Shtrati i Toplluhës është i thelluar në shkëmbinj të plio-kuaternarit (rërë, zhavorre, argjilë). Në afërsi të fshatit Piranë bashkohet me Drinin e Bardhë. (Valbon Bytyçi)

TOPOJANI Ajas Pashë (shek. XVI). Personalitet i shquar, vali, vezir në Perandorinë Osmane. Rrjedh nga një familje fisnike shqiptare me origjinë nga Topojani i Lumës (Shqipëri). Ishte biri i Ali Beut dhe vëllai i sadriazemit Koxha Sinan Pashës (shih). Ishte njëri nga valinjë (gubernatorët) dhe vezirët e shquar të sulltan Sylejmanit Ligjdhënës. Në vitin 1545 ishte emëruar vali i Bagdadit dhe në atë cilësi kishte ndërmarrë fushatën ushtarake kundër persianëve në Basra. Më pastaj kishte fituar titullin vezir, kurse në vitin 1549 e fitoi postin e valiut të Dijar Bekirit. Për shkak të përfshirjes në luftën e bijve të sulltan Sylejmanit për trashëgiminë e fronit, duke mbajtur anën e princ Bajazitit, në vitin 1558 u dënua me vdekje. Në Bjeshkët e Sharrit ka poseduar prona të mëdha të kullosave. Bijtë e tij kanë qenë Mahmud Pasha, Ibrahim Pasha dhe Mustafë Pasha. Mustafë Pasha një kohë të gjatë ka qenë vali i Prizrenit, ku në vitin 1562-63 ndërtoi njërën nga xhamitë më të bukura të këtij qyteti, e cila në vitin 1950 qe goditur nga rrufeja, kurse në vitin 1952 u rrënuar tërësisht dhe mbi të u ngrit Tregu i Gjellbër, më pas u ndërtua godina e Bankkos-it. Aktualisht në atë objekt është i vendosur Kuvendi Komunal i Prizrenit. (Sadik Mehmeti)

TOPOJANI Koxha Sinan Pashë (?-1596). Sadriazem (kryeministër) i Perandorisë Osmane. Njihet si Koxha Sinan pasha, Gazi Sinan Pasha ose "Pushtuesi i Jemenit". Pesë herë zuri postin e vezirit të madh dhe pesë herë të kryekomandantit ushtarak. Rrjedh nga një familje me origjinë nga fshati Topojan i Lumës. Ishte njëri nga tre djemtë e Ali Beut, i cili ishte njeri me ndikim dhe me pozitë në shoqëri. Ali Beu në Prizren ngriti katër ura, ndër to edhe Urën e njohur të Gurit, e ndërtuar më 1533, e cila qëndron edhe sot. Sinan Pasha komandoi shumë fushata ushtarake kundër Austrisë

përtej Danubit. Në vitin 1568 ishte caktuar mëkëmbës i Egjiptit, nga kishte nisur fushatën pushtuese kundër Jemenit të rebeluar, të cilin sërish ia ktheu Perandorisë. Në vitin 1571 u kthye në Kajro dhe dha urdhër për pastrimin e kanalit për ujitje nga Kajroja deri në Aleksandri, i cili kishte qenë jashtë përdorimit. Në vitin 1574 komandoi ushtrinë osmane në fushatën kundër Tunizisë, së bashku me kapitenin Këllëç Ali Pasha (shqiptar nga Ulqini). Në pranverën e vitit 1580 kishte udhëhequr ushtrinë osmane kundër Gjeorgjisë. Po në atë vit u caktua për herë të parë kryeministër. Kronistët turq, edhe pse i përmendin meritat për Perandorinë Osmane, shkruajnë se ka qenë i ashpër, mendjemadh dhe hakmarrës. Ia shohin për të madhe pse i ka ngritur shqiptarët në pozita të ndryshme. Peçevi e quan “Shqiptari kokëfortë”, historiani Hammer e quan “shqiptar i pazbutur”, kurse Jorga konsideron se ai ka qenë i fundit nga më të mëdhenjtë e periudhës së shkëlqyer të Perandorisë Osmane. Emri i Sinan Pashës është i lidhur ngushtë me Kaçanikun dhe ndërtimin e tij. Ka lënë vakëfe edhe në shumë vende, si në Shkup, Kratovë, Prishtinë, Vrajë, Gorë, Novobërdë, Ulqin etj. (Sadik Mehmeti)

TORLLAKISHTJA. Dialekti i sllavishtes jugore me tipare të gjuhëve ballkanike. Këtë dialekt dialektologët serbë e quajnë dialekt i Prizrenit dhe Timokut, që fillon nga pellgu i lumit Timok deri në Prizren dhe Gjakovë, si edhe në Dukagjin. Në Bullgari ky dialekt konsiderohet si dialekt i Bullgarisë Perëndimore, kurse në Maqedoni merret si dialekt i Maqedonisë. Torllakishtja i ka vetëm dy rasa: emëroren dhe kallëzoren (*od jutra do mrak* etj.), funksionin e rasave të tjera e kryen kallëzorja me parafjalët: *sas snau, o moju sestru*; përdoret përmirë për çdo vetë në formën “si” (*ja si iskam* etj.). E ka rimarrjen e kundrines me përmira vetorë (*men mi kaže, tebe te ne žalim*), si dhe ka një numër të konsiderueshëm huazimesh nga gjuha turke. Nuk ka paskajore, koha e ardhme ndërtohet me lidhëzën *da+koha e tashme* nga folja “hteti” (dua) e kohës së tashme dhe me formën *će* në vetën e 1 dhe 2 të njëjësit dhe të shumësit (*ću radim, će dočeka*). Krahasimi i mbiemrave bëhet sipas parimit analitik: shkallën krahasore e ndërton me lidhëzën *po+shkalla pohore*, kurse shkallën sipërore e ndërton me *naj+shkalla pohore* (*junak-pojunak-najjunak*). Një pjesë e këtij nëndialekti ka një shquese: *brat-ot, žena-*

ta. Nën ndikimin e gjuhës shqipe në Dukagjin, në këtë të folme serbe theksi i gjatë ngjitës ka ndryshuar në theks të gjatë zbritës në rrokjen e parafundit, duke u krahasuar me theksin e gjatë të gjuhës shqipe. Ruan bashkëtingëlloren rrokjeformuese *l* në një pjesë të rajonit të Timokut dhe Luzhnicës; sonanti i pandryshuar *l* në fund të rrokjes: *odnel, pobebele*; afrikatat *ć* dhe *đ* në zonën e Timokut dhe të Luzhnicës janë bërë më të forta dhe paraqiten si *č* dhe *đž*: *noč, gadžam*; okluzivet prapaqiellore *k* dhe *g* para qiellzoreve paraqiten si variante qiellzore të këtyre bashkëtingëlloreve *k', g'* gjë që ndonjëherë përdoren me afrikatat qiellzore *ć* dhe *đ*: *ruće, nođe*; fonema *h* gati është e panjohur në këtë të folme. (Naile Mala-Imami)

TOSKA Dijana (1961). Gazetare. Lindi në Shkup. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Shkup, ndërsa Fakultetin Juridik në Universitetin e Prishtinës. Punoi gazetare, korrespondente dhe producente e programeve politike dhe bashkëpunëtore e agjencive të ndryshme të lajmeve, vendëse e ndërkombëtare, si në Televizionin e Prishtinës, “Zërin e Amerikës” dhe ishte ligjëruese në Akademinë Policore në Vushtrri. Është bashkëpunëtore dhe drejtuese e disa organizatave joqeveritare që merren me liritë dhe të drejtat e njeriut në Kosovë. Është autore dhe producente e debateve të shumta televizive, e emisioneve dokumentare dhe e filmit dokumentar “Lugina e dhembjes dhe e shpresës, Bllaca”. Botoi librin “Maqedonia në gazetarinë time” (2014). (Besim Abazi)

TOSKA-NESIMI Valbona (1967-). Gjuhëtare, profesore. Shkollimin fillor dhe të mesëm i kreu në Shkup. Studioi për gjuhë dhe letërsi shqipe në Universitetin e Shkupit (1986-1990), ku kreu edhe studimet pasuniversitare dhe mbrojti tezën e disertacionit të doktoratës rreth kategorisë semantike të posesivitetit në gjuhën shqipe dhe maqedonase në kuadër të togfjalëshit emëror. Jep mësim në Universitetin e Shkupit për lëndët sintaksë e gjuhës shqipe, gramatikë, morfosintaksë dhe gjuhë e sotme shqipe. Me bashkautorë botoi monografinë “E tashmja” si nocion linguistik: mjetet gramatikore për shprehjen e ‘të tashmes’ në gjuhët sllave dhe ballkanike” (2010) dhe artikujt shkencorë kryesisht për ndikimet e maqedonishtes në shqipen dhe për gjendjen e shqipes standarde në Maqedoni. (Berton Sulejmani)

TOSKE NË MAQEDONI (TË FOLMET). Përgjithësisht të folmet shqipe në Maqedoni i takojnë gegërishtes qendrore, që shtrihen në vazhdimësi territoriale e etnike nga Kumanova e deri në Strugë (Kumanova, Karadaku i Shkupit, Karshiaka, Derveni, Tetova, Gostivari, Kërçova, Prilepi, Krusheva, Dibra, përfshirë edhe fshatrat e pjesës lindore të Strugës). Në krahun e djathtë të rrjedhës së lumit Drini i Zi shtrihen të folmet gege (Misleheva, Livadhia, Dellogozhda, Koroshishti, Tateshi i Epërm e i Poshtëm, Dobovjani, Poumi, Mislodezhda). Në krahun e majtë të Drinit të Zi shtrihen të folmet toske (Frëngova, Ladorishti, Shumi, Zagraçani, Veleshta, Belica e Epërme dhe e Poshtme, Llabunishta etj.). Të folmet shqipe në pjesën jugperëndimore të Maqedonisë, duke filluar nga pjesa jugore e Strugës dhe që përfshijnë Ohrit, Manastirin, Prespën dhe Resnjën janë të folme të toskërishtes veriore. E folmja e qytetit të Strugës dhe e qytetit të Ohrit me lëvizjet fshat-qytet tani më nuk mund të karakterizohen se janë as gege e as toske. Ato sot janë shndërruar në të folme kalimtare me më shumë elemente toske. Shqiptarët anas të Ohrit janë shpërngulur në Turqi, në Strugë, në Shkup e në vende të tjera; disa nga myslimanët janë turqizuar, ortodoksët janë sllavizuar, fshatra të tëra shqiptare janë shfarosur, djegur e asimiluar (kështu e pësuan fshatrat Peshçani, Volina, Podmulli, Rashçe, Orovnik, Tërpejca, Lubanishta, Peshani, Shën Naumi (Sari Salltëk) etj.). Shumica e shqiptarëve të sotëm të Ohrit janë të ardhur nga rrethi i Strugës, më shumë gegë, por edhe toskë. Gjatë këtyre 50-60 vjetëve të fundit, sidomos pas konfliktit të armatosur në Maqedoni (2001) e më pas, shqiptarët e Ohrit po shpërngulen në Strugë, ndërsa nga politika e pastrimit etnik Manastiri pothuajse është sllavizuar tërësisht. (Berton Sulejmani)

TOSKËRISHTJA. Njëri ndër dy kryedialektet e gjuhës shqipe, që zë vend nga krahu i majtë i lumit Shkumbin e deri te Gjiri i Prevezës. Si njësi dialektore e dytë për nga madhësia ndahet në dy nëndialekte: në toskërishten veriore dhe në toskërishten jugore. Toskërishtja veriore shtrihet në rrethet e Beratit, të Fierit, të Skraparit, të Pogradecit, të Korçës, të Kolonjës, në zonat e rretheve të Përmetit, të Tepelenës e të Vlorës, që zënë vend në anën e djathtë të Vjosës. Ky areal dialektor i toskërishtes veriore

ndahet në dy grupe: në grupin perëndimor dhe në grupin lindor. Grupit perëndimor i toskërishtes veriore kap të folmet e Myzeqesë, të Beratit, të Mallakastrës, të Skraparit dhe të Vlorës me rrethinat e saj. Ndërsa grupit lindor të toskërishtes veriore i përkasin të folmet e rrethit të Korçës, të Oparit, të Gorës, të Pogradecit dhe të Devollit. Toskërishtja jugore gjithashtu ndahet në dy njësi dialektore, që për nga shtrirja janë më të vogla se të toskërishtes veriore. Këto kapin dy njësi dialektore: labërishten dhe çamërishten. Si kufi, që i ndan këto të folme konsiderohet lumi i Shalësit. Labërishtja shtrihet në tërë Labërinë dhe në krahinëzat e rrethit të Gjirokastrës. Çamërishtja përfshin Murrësin, Konispolin e ndonjë fshat tjetër brenda kufirit politik të Shqipërisë Jugore, duke vazhduar brenda Greqisë në tërë Çamërinë deri te Preveza. Të folmet çame karakterizohen me disa tipare arkaike të shqipes, siç janë: ruajtja e grupeve të vjetra konsonantike: *kl, gl*; ruajtja e *l*-së së moçme në pozicion intervokalik, kuantiteti i vokaleve etj. Të gjitha këto flasin bindshëm edhe për lashtësinë e shqiptarëve në ato troje. Ndërsa të folmet shqipe, të cilat shtrihen midis Liqenit të Ohrit dhe të Prespës, janë vijim i të folmeve toske të Korçës dhe të Pogradecit, që të tërat këto formojnë njësinë dialektore të toskërishtes veriore. Me veçoritë gjuhësore të toskërishtes karakterizohet edhe pjesa më e madhe e të folmeve të italo-arbërishtes dhe e arvanitishtes së Greqisë. Si specifika qenësore të toskërishtes veçohen: grupi *va-* (*vatër-votër*), mënjanimi i infinitivit të tipit: *me bā*-, *me punue*-, , reduktimi kuantitetit të vokaleve me vlerë fonologjike: *plak-plakë -plak-pla:k*, rotacizimi i *n*-së intervokalike: *vera-vëna, bëra-bāna, zëri-zāni* etj. (Imri Badallaj)

TOSKIZMAT. Dialektizma që me veçoritë dhe specifikat e tyre i takojnë dialektit toskë, por përdoren edhe në varietete të tjera. Toskizëm janë fjalët: *dimër, lëmi, nëntë, shëllirë, vreshtënjë, dimri, lëmi, nënë, shëllirë, vreshtë, mëllënja, kacidhe, kaposh, çupë, mëndje* etj. Po ashtu, toskizëm janë edhe dukuritë fonologjike të shurdhimit të bashkëtingëllores në fund të fjalës: *Vënt* (vend), *i math* (i madh), standart (standard). Toskizma mund të konsiderohet edhe elementet toske të përfshira në standard: zhdukja e paskajores, pjesorja me *-ur*, grupi *va* në vend të *vo*, rotacizmi e kështu me radhë. (Imri Badallaj)

TOVËRLANI Afrim (1967-). Futbollist, trajner. Lindi në Prishtinë, ku kreu shkollimin fillor, të mesëm dhe Fakultetin e Kulturës Fizike. Me lojën e futbollit nisi të merret në moshë të re. Nga viti 1979 e deri më 1984 ishte në grupmoshat e reja, kurse nga viti 1984 deri më 2003 pjesë e ekipit të parë të KF "Prishtina". Ka të zhvilluara mbi 600 ndeshje dhe është rekordmen i të gjitha kohëve në Prishtinë për nga numri i ndeshjeve. Për Prishtinën ka luajtur në Ligën e parë dhe të dytë të ish-Jugosllavisë dhe ishte pjesë e përfaqësueseve të reja të ish-Jugosllavisë U-17 dhe U-19. Si futbollist, me "Prishtinën" ka fituar 5 tituj të kampionit të Kosovës, 2 kupa dhe 3 superkupa. Karrierën si trajner e filloi në vitin 1998 me kategoritë e reja në KF "Prishtina". Në vitet 2007-2009 bëhet pjesë e shtabit teknik e ekipit të parë në KF "Prishtina". Në edicionin 2009-2010 emërohet trajner i KF "Trepça'89", kur kjo skuadër ishte në ligën e parë dhe kthehet në superligë. Në vitin 2012 kthehet në radhët e KF "Prishtina", ku i fiton të gjithë trofetë e mundshëm. Nga Federta e Futbollit të Kosovës dy herë është shpallur trajner i vitit (2008 dhe 2013). (Baki Berisha)

TRAJMER Karl (Treimer) (1892-1976). Indo-europianist, albanolog. Studiues gjerman nga Austria, i lindur në Bërno të Moravisë (Çeki). Doktor i filologjisë dhe docent në Institutin e Gjuhëve Indoeuropiane në Universitetin e Vjenës. Kryetar i parë i Shoqatës Austriako-Shqiptare. Ndoqi leksione te N. Jokli, P. Kreqçmeri, Majer-Lybke. U doktorua me temën "Kontribute për historinë e gjuhës shqipe" (Beiträge zur albanischen Sprachgeschichte). Pas doktorimit, punoi mësues në Bërno deri më 1939. Më 1948 u emërua docent i filologjisë sllave në Universitetin e Gracit dhe më 1951 në Universitetin e Vjenës. Më 1952 u caktua ligjërues i kurseve të shqipes në Institutin e Indoeuropianistikës në Universitetin e Vjenës, ku mbajti ligjërata nga fusha të ndryshme të albanologjisë. Pas vitit 1962 mbajti leksione për shqipen. Ishte njohës i letërsisë shqipe, i historisë së gjuhës shqipe, i marrëdhënieve të saj me gjuhët ballkanike, e në veçanti me ato sllave, i dialektologjisë, i së drejtës zakonore, i etnologjisë dhe i etnogenezës shqiptare. Botoi përmbledhjen "Nga deti në det - përralla folkloristike shqiptare" (Tiranë, 1976). (Shpëtim Elezi)

TRAKËT. Grup i fiseve indoeuropiane, të cilët popullonin një zonë të gjerë të pjesës lindore të Europës Juglindore. Në kufirin verior kishin skythët, në lindje Detin e Zi, në jug grekët dhe në perëndim ilirët dhe, më pas, edhe keltët. Flisnin gjuhë trakase, e cila pothuajse është vërtetuar se i takon familjes së gjuhëve indoeuropiane. Shënimi i parë historik për thrakët gjendet në veprën "Iliada" të Homerit, ku janë përshkruar si aleatë të trojanëve në luftë kundër grekëve. Ata përmenden gjithashtu edhe nga autorët antikë si Polibi, Cicëroni, Tit Livi, Straboni dhe Plini. Polibi i përmend sidomos në kontekst të konfliktit dardano-maqedon, duke vënë në pah rolin që luajtën ata kundër dardanëve në këtë rast. Duke qenë fqinjë me dardanët, prania e tyre është dëshmuar edhe në Dardani, përmes monumenteve epigrafike, si dhe të dhënave onomastike dhe atyre të kultit. Në mesin e hyjnive trakas të cilëve u janë ngritur monumente në Dardani janë *Zbelturdus* dhe Kalorësi Thrakas. Prania dhe adhurimi i kulteve të trakasve në Dardani lidhet me afërsinë e tyre gjeografike me Dardaninë. Për këtë arsye edhe pjesa më e madhe e përkushtimeve janë dëshmuar në territorin e Serbisë dhe Maqedonisë së sotme. (Emine Kalaja-Hajdari)

TRAKISHTJA. Gjuhë indoeuropiane, gjuhë e trakasve të lashtë që kanë jetuar në lindje të lumenjve Morava e Vardar, në jug të Danubit, deri në Egje dhe Det të Zi. Janë shtrirë në pjesën më të madhe të Bullgarisë së sotme, në pjesën lindore të Maqedonisë, por edhe në ujdhesat Tasos e Lemnos të Greqisë. Një pjesë e trakasve është greqizuar, ndërsa një tjetër është romanizuar. Ka pak të dhëna për të. Gjuhëtarët e shohin si gjuhë satem në kuadër të gjuhëve indoeuropiane, ose me ndikime të fuqishme të gjuhëve satem. Disa autorë si dialekte të trakishtes i konsiderojnë mezishten, dakishten dhe getishten. Njihet me disa glosa, emra njerëzish dhe tri fraza të shkurtra. Disa autorë kanë shtruar hipoteza se trakishtja mund të jetë paraardhëse e shqipes, por kjo nuk është ngritur asnjëherë në mendim të pranuar në mesin e gjuhëtarëve. (Bardh Rugova)

TRAKTATI I BERLINIT (1878). Marrëveshje e Fuqive të Mëdha për të zhvlerësuar vendimet e Traktatit të Shën Stefanit (3 mars 1878). Traktati u miratua nga Kongresi i Berlinit që u mbajt nga 13 qershori deri më 7 korrik



HARTA E BALLKANIT PAS TRAKTATIT TË BERLINIT

1878. Traktati ka 64 nene, në të cilat janë saktësuar kushtet e paqes midis Perandorisë Ruse, si fituese dhe Perandorisë Osmane, si humbëse e luftës, si dhe një sërë vendimesh të tjera lidhur me “Krizën Lindore”. Kongresi i Berlinit miratoi edhe 20 protokolle, në të cilat janë regjistruar bisedimet, vendimet dhe rekomandimet për një varg çështjesh specifike. Në bazë të Traktatit të Berlinit, Rusia u zhbë si fuqi detare në Detin e Zi, ndërsa Perandoria Osmane u ruajt si fuqi europiane. Bullgaria u nda në dy pjesë, në Principatën Bullgare, vasale e Turqisë dhe Rumelinë Lindore, provincë autonome e Perandorisë Osmane. Rusia përfitoi disa territore, si Besarabia, Ardahani, Karsi dhe Batumi. Austro-Hungaria fitoi të drejtën e okupimit të Bosnjës dhe Hercegovinës (jo aneksimit) dhe të mbajtjes së një garnizoni ushtarak në sanxhakun e Pazarit të Ri. Traktati njohu pavarësinë e Rumanisë, të Serbisë dhe të Malit të Zi. Në vend të parimit të kombësisë, Traktati vuri në qendër parimin e “ndarjes së plaçkës”. Nenet nr. 23, 28, 29 të këtij Traktati, si dhe protokollat nr. 7, 8, 10, 12, 13, 15, 16, 19 prekin drejtpërdrejt ose tërthorazi interesat e shqiptarëve. Me këto vendime Serbisë iu dhanë territoret shqiptare të Nishit, Pirotit, Vrajës, Kurshumlisë, Preokupljes etj. Malit të Zi do t’i kalonin territore shqiptare si Tivari, Podgorica, Plava dhe Gucia. Në bazë të protokollit nr. 13 u rekomandua ratifikim kufijsh midis Portës së Lartë dhe Greqisë, gjë që rrezikonte humbjen

e territoreve shqiptare në Çamëri. U ruajtën privilegjet e Krahinës së Mirditës, vendim që në rrethanat e atëhershme rrezikonte copëzimin e mëtejshëm të Shqipërisë. Në bazë të nenit 23, Perandoria Osmane fitoi të drejtën për të ruajtur ndarjen administrative në fuqi, vendim që binte në kundërshtim me aspiratën e shqiptarëve për bashkimin e viseve shqiptare në një vilajet të vetëm. (Islam Lauka)

TRAKTATI I SHËN STEFANIT (1878).

Marrëveshje e paqes ndërmjet Perandorisë Osmane dhe Ruisë, që u nënshkrua më 3 mars 1878, pas përfundimit të luftës rusoturke, të cilën e fitoi Rusia. Traktati i Shën Stefanit përfshinte çështje, të cilat kishin të bënin drejtpërdrejt me dy vendet, por edhe me sferat e tyre të interesit. Sipas Traktatit, Rusia i shkëputte Perandorisë Osmane në Ballkan dhe në Kaukaz një sipërfaqe prej rreth 350,000 km², prej të cilave rreth 280,000 km² ose rreth 80% e zotërimeve të Perandorisë Osmane në Europën Juglindore. Traktati nxiti reagime të ashpra të Britanisë së Madhe, të Austro-Hungarisë, të Gjermania, Italisë dhe Francës, të cilat shfaqën hapur mospajtimin e tyre me përmbajtjen e kësaj marrëveshjeje. Traktati i Shën Stefanit cenonte rëndë edhe territoret shqiptare. Një pjesë e madhe e tyre mbetej nën sundimin e Perandorisë Osmane, kurse pjesë të tjera u jepeshin aleatëve të Ruisë. Sipas Traktatit, Bullgaria do të merrte, përveç tjerash, rrethet e Korçës, Pogradecit, Strugës, Dibrës, Kërçovës, Gostivarit, Tetovës, Kumanovës dhe Kaçanikut. Serbia do të aneksonte viset veriore të Kosovës, deri në afërsi të Mitrovicës. Mali i Zi do të përfshinte brenda kufijve të tij, ndër të tjera, krahinat shqiptare të Ulqinit, Krajës, Anamalit, Hotit, Grudës, Tuzit, Kelmendit, Gucisë, Plavës dhe Rugovës. (Frashër Demaj)

TRAKTATI I VERSAJËS (28 qershor 1919).

Traktat i nënshkruar ndërmjet fuqive aleate dhe Gjermanisë në mbarim të Luftës së Parë Botërore. Bisedimet filluan më 18 janar 1919 dhe përfunduan më 28 qershor 1919. Sa i përket Shqipërisë, dy vendet që e kishin ndihmuar në Konferencën e Londrës (1913), Austro-Hungaria dhe Gjermania kishin dalë humbëse në Luftën e Parë Botërore. Në anë tjetër, shtetet e Ballkanit, Jugosllavia dhe Greqia kishin shpallur pretendime të reja ndaj territoreve të Shqipërisë, kurse Italia kishte



PJESËMARRËSIT NË KONFERENCËN E VERSAJËS

pushtuar Vlorën. Mbrojtjen e Shqipërisë, me nxitjen edhe të Vatikanit, e kishte marrë përsipër SHBA-ja, ndërsa vetë Shqipëria nuk kishte të drejtë pjesëmarrjeje, sepse nuk ishte njohur si shtet në një kohë që në rrethet e Konferencës përfaqësohej me pesë delegacione të pakoordinuara. Delegacionet e Shqipërisë i paraqitën Konferencës dy memorandume, njërin që kërkonte revidimin e vendimeve të padrejta të Konferencës së Londrës (1913) dhe me memorandumun tjetër kërkonte vendosjen e kontrollit amerikan për dy vjet mbi territoret e aneksuara dhe më pas të zhvillohej një plebishit. Në njëfarë forme 14 pikat e presidentit amerikan Vilson edhe në parimet e Konferencës i kishin dhenë mbështetje sovranitetit të Shqipërisë, por as vetë amerikanët nuk kishin shumë qartësi rreth situatës në terren. Për këtë arsye, disa qytete të Shqipërisë, ndaj të cilëve kishin pretendime shtetet fqinje (Vlorë, Gjirokastër, Korçë, Shkodër etj.), më 1919 i vizitoi konsulli amerikan në Torino, Jozef Havente, dhe me këtë rast ai bëri një raport të favorshëm për Shqipërinë. Por një vit më vonë, në janar të vitit 1920, Britania, Franca dhe Italia arritën marrëveshje për ta copëtuar Shqipërinë ndërmjet Greqisë, Mbretërisë Serbe-Kroate-Slllovene dhe Italisë. Por kjo marrëveshje nuk u realizua, për shkak të kundërshtimit të ashpër të shqiptarëve. Rol të rëndësishëm në moszbatimin e planeve për ndarjen e Shqipërisë pati qëndrimi i SHBA-së, e cila nuk e kishte nënshkruar Traktain e Fshehtë të Londrës të vitit 1915, por as atë të Versajës. Me Konferencën e Paqes në Paris nuk u bë copëtimi i mëtejshëm i Shqipërisë, por as revidimi pozitiv i kufijve të saj të 1913-ës. (Izber Hoti)

TRANSFERI ELEKTRONIK I PAGESAVE.

Pagesat elektronike, të cilat janë të sigurta dhe efikase dhe kanë një përdorim gjithnjë e më të madh, mbështeten në teknologjinë elektronike, në vend të instrumenteve të letrës për kryerjen e transaksioneve individuale të pagesave. Janë disa forma të kryerjes së transfereve elektronike të fondeve, prej të cilave në Kosovë dominojnë format përmes terminaleve elektronike të bankave dhe pajisjeve kompjuterike personale, si dhe format e debitimit me paraautorizim. Pajisjet e pikave të shitjes janë terminale elektronike të bankave që mundësojnë qasje në bankë për nevoja të kryerjes së pagesave. Ato mundësojnë të bëhen blerje apo pagesa me kartë të veçantë. Bankomatët po ashtu janë terminale elektronike të bankave dhe mundësojnë qasje në bankë pothuajse në çdo kohë. Pos për të tërhequr para dhe për të bërë depozita, bankomatët mund të përdoren edhe për të transferuar fonde ndërmjet llogarive. Bankingu me pajisje kompjuterike personale mundëson kryerjen e shumë transaksioneve bankare, si transfere mes llogarive dhe pagesa të faturave. Për kryerje të një transaksioni kërkohen lidhja e internetit dhe kredencialet personale bankare. Debitimi me paraautorizim mundëson që me autorizim paraprak të njëhershëm të realizohen në mënyrë automatike pagesat që përsëriten periodikisht. Kosova është inkuadruar në sistemin ndërkombëtar elektronik të pagesave. (Bedri Hamza)

TRANSPORTI URBAN. Sistem i pajisjeve transportuese dhe i aktiviteteve për të përmbushur nevojat e qytetarëve për lëvizjen brenda një qyteti apo të një komune. Merret si një nga shërbimet publike me ndikim në cilësinë e jetës dhe përmbushjen e nevojave të përditshme të banorëve, sidomos për vajtje dhe kthim nga puna po edhe për nevojat e tjera. Trafiku urban në Kosovë thuhet kryesisht kufizohet në përdorimin e autobusëve dhe është i organizuar në ndërmarrje publike komunale, me një pjesëmarrje edhe të operatorëve privatë. (Ymer Havolli)

TRANSPORTI. Veprimtari ekonomike për të siguruar mobilitetin e njerëzve, të mallrave dhe të prodhimeve për lëvizjen apo transferin e tyre prej një vendi në vendin tjetër. Ky transfer bëhet nëpërmjet automjeteve, trenit, aeroplanëve, anijeve. Kostoja dhe cilësia e transportit ka

ndikim të madh në ekonominë e një vendi dhe tërheqjen e investime. Konsiderohet se vendet që kanë mundësi të transportit detar, hekurudhor dhe janë të integruar në forma të tjera të transportit të ashtuquajtur multimodal, krijojnë kushte më të mira zhvillimi dhe kanë përparësi krahasuese për të siguruar aftësinë konkurruese të ekonomisë. Transporti në Kosovë kryesisht është i përqendruar në atë automobilistik, më pak në atë hekurudhor dhe ajror. Ndërkaq, me transportin detar kryesisht lidhet nëpërmjet rrugëve me Portin e Durrësit, atë të Selanikut ose të Tivarit. Kostoja dhe cilësia joadekuate e transportit kërkon investime në infrastrukturë dhe pajisje të tjera. Aktualisht transporti krijon mbi 4% të prodhimit të brendshëm bruto të Kosovës. (Ymer Havolli)

TRE KAPITUJT (TRIA CAPITULA). Dekreti i perandorit Justinian për ta pajtuar pjesën Lindore dhe Perëndimore të Perandorisë në rrafshin religjioz. Dekreti në tre kapitujt i vitit 544 u nxit nga disa ipeshkvij lindorë dhe në të dënohet Teodor Mopsueti, për shkak të ideve nosteriane dhe besimeve të kota, pastaj shkrimet e Teodoretit, në të cilat dënonte Qirilin e Aleksandrisë dhe Koncilin e Efesit, si dhe një letërqarkore të Ibes së Edesit. Dekreti shkaktoi shumë pakënaqësi, kundërshtim dhe tronditje në gjithë Perandorinë. Në mesin e kundërshtareve të Tre Kapitujve ishin edhe ipeshkvijtë nga Dardania. Në mbledhjen e Sinodit Krahinor (549) edhe ipeshkvijtë e Ilirikut e dënuan Benenatin, argjipeshkvin e Justiniana Primës, për përkrahjen e Tre Kapitujve. Megjithëkëtë, dekreti u aprovua në koncilin e Konstandinopojës (553) nën presionin e perandorit, pavarësisht nga kundërshtimet. Ipeshkvijtë e Dardanisë (Benenati, Projekti, Pali), edhe pse ishin në Konstandinopojë, nuk morën pjesë në punimet e Koncilit. Mendohet se lufta qytetare në Ulpianë në vitin 552, për të cilën njofton Prokopi, është e lidhur me mosmarrëveshjet religjioze rreth Tre Kapitujve. (Arben Hajdari)

TREGUESIT MAKROEKONOMIKË. Paraqesin një informatë apo statistikë ekonomike dhe përdoren për të vlerësuar ecuritë ekonomike e sociale të një vendi në tërësi. Treguesit makroekonomikë janë një informacion i domosdoshëm për krijuesit dhe zbatuesit e politikave ekonomike. Përdorimi i treguesve

është i vlefshëm vetëm nëse ata interpretohen në mënyrë korrekte. Treguesit përdoren për analiza ekonomike nga institucione të ndryshme, si dhe nga investitorët, për të interpretuar mundësitë e investimeve. Treguesit kryesorë makroekonomikë që kanë vëmendje të gjerë dhe konsiderohen nga qeveritë, nga investitorët si dhe nga organizatat e ndryshme profesionale, përfshijnë: prodhimin e brendshëm bruto (PBB) në vlerë absolute dhe për një banor, normën e rritjes reale ekonomike, treguesin e çmimeve të konsumit, normën e inflacionit, normën e papunësisë, treguesin e varfërisë, ecurinë e bilancit tregtar etj. Sipas këtyre treguesve, Kosova vazhdon të jetë vendi më i varfër në rajon (mes 12% -18% e popullatës jeton në varfëri ekstreme), edhe pse ka shënuar një trend rritës të PBB-së ndër vite, me një rritje mesatare prej rreth 3.7% gjatë dhjetëvjeçarit të fundit. Inflacioni gjatë kësaj periudhe ka qenë stabil, në mesatare prej 2%, por kryesisht i ndikuar nga lëvizjet e çmimeve në vendet nga të cilat importohen mallrat dhe shërbimet. Norma e papunësisë nga rreth 40%, sa ishte 10 vjet më parë, është ulur në rreth 30% ndërmjet viteve 2012/13 dhe është rritur në rreth 35% në vitin 2014, ndërsa deficiti tregtar në mallra dhe shërbime (eksporti i parasë së gatshme) vazhdimisht ka shënuar rritje (nga 1.1 miliard euro sa ishte në vitin 2005, është rritur në rreth 1.9 miliard euro në vitin 2014). Tregues të tjerë të rëndësishëm janë edhe treguesit financiarë, fiskalë e monetarë, të cilët karakterizojnë gjendjen dhe ndryshimet e ofertës monetare, nivelin dhe ecurinë e normave të interesit, të kurseve valutore, të deficitit buxhetor, të borxhit publik etj. Kosova ndër vite ka shënuar normat me të larta të interesit për kredi në rajon. Megjithatë, sistemi financiar në vend është dëshmuar të jetë i qëndrueshëm. Borxhi publik ka shënuar rritje graduale në vitet e fundit, megjithatë vazhdon të jetë më i ulëti në rajon. Ndër institucionet kryesore që bëjnë analizën dhe publikimin e të dhënave statistikore makroekonomike në Kosovë janë: Agjencia e Statistikave e Kosovës, Banka Qendrore e Kosovës, Qeveria e Kosovës, Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore. (Fisnik Reçica)

TREPÇA MESJETARE. Si vendbanim xehetar ishte i njohur që nga periudha antike. Etimologjia e emrit Trepça sugjeron mundësinë e lidhjes me emrin e një fisi të vogël ilir-arbëror

të quajtur Trepçi. Si qytet xehtar mesjetar Trepça për herë të parë përmendet në dokumente zyrtare në vitin 1303, ku qysh më herët ekzistonte organizimi kishtar katolik. Gjatë shekujve të mesjetës, Trepça ishte qyteti kryesor i zonës xehtarë të Kopaonikut, ku nxirrej argjendi, ari dhe plumbi. Këto minerale i dhanë famë xeheroreve të Trepçës përgjatë mesjetës së vonshme dhe shekujve të parë të sundimit osman. Për mbrojtjen e pasurisë së xeheroreve të Trepçës, krahas kështjellës së Zveçanit, ekzistonte në pjesën jugore të Trepçës dhe në lindje të Mitrovicës fortifikata e quajtur nga vendorët Qytet (Gjytet).

Burimet historike njoftojnë se në Trepçë jetonte një popullatë mjaft e larmishme. Krahas popullsisë autoktone arbërore dhe sllave-skizmatike, aty jetonin edhe kolonistë sasë, raguzanë, kottoras, tivaras, ulqinakë, splitas etj. Me zhvillimin e shpejt të xehtarisë, në trevën xehtarë të Trepçës u themeluan edhe tregje të njohura lokale, si tregu i Shën Dhimitrit, i Zveçanit dhe i qytetit të Trepçës etj. Këto tregje ishin të lidhura me një rrjet të dendur rrugësh antike të karvanëve. Për shkak të rëndësisë dhe pasurisë së xeheroreve të Trepçës, pjesa më e madhe e rrugëve ballkanike përfundonin në Trepçë.

Sikurse edhe në qytetet e tjera xehtarë mesjetare, edhe në Trepçë sundonte princi, por pas Betejës së Parë të Kosovës, deri në rënien nën osmanët (1455), në këtë qytet kishte bashkëqeverisje të princërve vendorë me administrues osmanë. Një dokument raguzan i vitit 1409 dëshmon se osmanët ngritën në Trepçë një lagje të tyre të quajtur nga kolonistët raguzanë *Triepza Turcha*. Burimet e kohës njoftojnë se gjatë dy dekadave të para të shek. XV funksiononte po ashtu edhe dogana e këtij qyteti. Në dekadat e para të shek. XV përmendet farkëtaria për prerjen e monedhave, si dhe zhvillimi i zejeve të ndryshme nga metalet, sidomos zeja e argjendarisë. Në vitet '30 të shek. XV përmendet edhe taraphania osmane, ku preheshin monedha osmane.

Numri në rritje i kolonistëve raguzanë bëri që në këtë qytet në fillim të shek. XV të përmenden dy kisha katolike: e Shën Mërisë dhe e Shën Pjetrit. Në gjysmën e parë të shek. XV raguzanët themeluan në afërsi të Trepçës dhe Vushtrrisë edhe një koloni të tyre të vogël të quajtur *De Dimitrouic* (Mitrovica e sotme). Raguzanët në Trepçë hapën edhe konsullatën e tyre, e cila merrej edhe më çështje ekonomike,

në mbrojtje të interesave të tregtarëve raguzanë. Ndonëse njihej si koloni e madhe raguzane, pas rënies së Trepçës nën sundimin osman, numri i raguzanëve këtu, sikurse edhe në qytete të tjera të Kosovës, filloi të bjerë, meqë administrata osmane ndalonte eksportimin e argjendit dhe të plumbit të Trepçës. Kronistët osmanë njoftojnë se pas pushtimit të Trepçës (1455), sulltan Mehmeti II kishte gjetur në fortifikatën e saj një thesar përrallor. Në periudhën osmane Trepça, si vendbanim i rëndësishëm, krahas organeve administrative të qytetit kishte dhe ligjin e vet të veçantë. Si has i sulltanit, nga mesi i shek. XVI (1544) Trepça kishte 76 amvisëri të përkatësisë islame dhe 277 amvisëri të krishtera, me të ardhura mbi 200,000 akçe. Luftërat austro-osmane (1683-1699) i dhanë goditje të rëndë eksploatimit të xeheroreve të Trepçës. (Gazmend Rizaj)

TRIBUNALI I HAGËS. Gjykatë ndërkombëtare për krimet e luftës në ish-Jugosllavi. Emërtimi i plotë i saj është "Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen e Personave



NJË SEANCË E TRIBUNALIT TË HAGËS

Përgjegjës për Shkeljet e Rënda të së Drejtës Ndërkombëtare Humanitare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë prej vitit 1991" (shkurt: Tribunali i Hagës). Tribunali i Hagës u themelua pas krimeve të armatës, policisë dhe paramilitarëve serbë gjatë viteve 1991-1995 në Bosnjë e Hercegovinë dhe Kroaci. Këshilli i Sigurimit i OKB-së, me Rezolutën nr. 827/1993 (22 shkurt 1993), e themeloi këtë Gjykatë me seli në Hagë për gjykimin e personave përgjegjës për këto krime. Gjykata e shtriu juridiksionin edhe në Kosovë, ngase me shpërthimin e luftës gjatë periudhës 1998 deri më 12 qershor 1999, forcat ushtarake, policore dhe paramilitare

serbe vranë rreth 13,000 shqiptarë, shumica popullsi civile, deportuan me dhunë rreth 800,000 shqiptarë të Kosovës dhe plaçkitën e shkatërruan rreth 100,000 shtëpi dhe objekte të tjera. Sipas konventave të Gjenevës dhe të Hagës, të gjitha këto vepra konsiderohen krime të luftës dhe krime kundër njerëzimit. Baza ligjore që e rregullon punën e kësaj Gjykate është Statuti dhe Rregullat e Procedurave dhe të Evidencave. Normat e Statutit, në të vërtetë, janë norma të ligjit penal, të procedurës penale dhe të ekzekutimit të dënimeve. Statutin e kësaj Gjykate e ka aprovuar Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, ndërsa normat e tjera i ka aprovuar vetë kjo Gjykatë. Gjykata përbëhet nga Dhoma e Gjykitimit dhe Dhoma e Apelit, nga Zyra e Prokurorit dhe Sekretaria. Gjyqtarët dhe prokurorët janë emëruar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së. Juridiksioni i kësaj Gjykate shtrihet mbi personat fizikë dhe jo mbi shtetet dhe personat juridikë. Kjo Gjykatë është e karakterit ad hoc dhe është kompetente për shkeljet e rënda të Konventave të Gjenevës, për shkeljet e ligjeve dhe të zakoneve ndërkombëtare, për krimet e gjenocidit dhe krimet kundër njerëzimit. Gjatë punës së saj njëzetyjeçare janë akuzuar disa ish-pushtetarë të rëndësishëm të ish-Jugosllavisë, në mesin e të cilëve edhe Slobodan Millosheviqi. Tribunali i Hagës u themelua vetëm për gjykimin e kriminelëve të luftës në ish-Jugosllavi, por praktika e tij gjyqësore krijoi bazë solide për realizimin e idesë për themelimin e Gjykatës Penale Ndërkombëtare të Përhershme (e themeluar më 11 prill 2002 me seli në Hagë), e njohur si “Gjykatë e Romës”. (Ismet Salihu)

TRIFIQ (Trifić) Tomislav (1949-). Grafist. Lindi në Lipjan. U diplomua në Akademinë e Arteve në Prishtinë, drejtimi i grafikës (1979). Krijimtaria grafike e tij përfshin elemente përmbajtësore strukturale, të cilat i definojnë qartë synimet ideore të realizuara me shkathësi në teknikën e akuatintës. Figura, portrete, zogj si kompozicione të lira janë temat që e preokupojnë. Hapi ekspozitën personale në Galerinë “Sonja Marinković” në Novi-Sad më 1979, ndërsa më 1981 në “Kolektivin Grafik” në Beograd. Organizoi edhe shumë ekspozita të tjera personale në Prishtinë, Beograd, Pejë, Shkup, Krushevac, Nish, Kragujevac etj. Pas vitit 1979 mori pjesë në mbi tridhjetë ekspozita kolektive si në vend, ashtu dhe jashtë, si dhe

në ekspozitën “Grafika e krijuesve kosovarë” të organizuar në Dubrovnik, Zagreb, Lubjanë, Palermo, Damask, Munihi e Londër. Ishte mësimdhës i grafikës në Zvečan. (Fatmir Krypa)

TROCKI Leon (Lev Davidovich Bronstein) (1879-1940). Politikan rus, gazetar, njëri nga udhëheqësit e Revolucionit të Tetorit, kundërshtar i madh i Stalinit. Lindi në fshatin



LEON TROCKI

Yanovka në Ukrainë, në një familje hebraike. Në vitin 1897 ndihmoi në krijimin e Sindikatës së Punëtorëve të Rusisë Jugore, për çka u dënua katër vjet burg në Siberi. Më pas u arratis në Londër, ku u takua me Leninin dhe u bë pjesë e Partisë Socialdemokrate. Në vitin 1905 mori pjesë në kryengritjen kundër carit rus, ku sërish burgoset dhe dërgohet në Siberi. Në vitin 1907 përsëri arratiset dhe për dhjetë vjet qëndroi në Europë dhe Amerikë. Shkroi artikuj për gazetat “Pravda”, “Proletary”, “Luch” dhe “Odesskie Novosti”. Ishte korrespondent nga Vjena për të përditshmen liberale-majtiste “Kievskaya Mysl” të Kievit dhe më 1912 korrespondent nga Ballkani. Përcolli zhvillimet e luftërave ballkanike dhe u tmerrua nga masakrat e ushtrive serbe dhe bullgare. Raportonte se vrasjet masive të shqiptarëve dhe shkatërrimi i vendbanimeve të tyre kishin qëllim shfarosjen e popullsisë dhe ndryshimin e përbërjes etnike. Më 1926 botoi përmbledhjen e shkrimeve “Ballkani dhe luftërat ballkanike”. Më 1917 u bashkua me Leninin në Revolucionin e Tetorit. Ishte themelues dhe drejtues i Ushtrisë së Kuqe. Me ardhjen e Stalinit në pushtet, u shmang gradualisht nga pushteti. Më 1927 përjashtohet nga Komiteti Qendror dhe më 1929 dënohet me dëbim nga Bashkimi Sovjetik. Ishte ideator i trotckizmit, një lëvizje ideore-politike që kundërshtonte stalinizmin. Vdiq në Meksiko Siti, pas një atentati nga një agjent i Stalinit. (Arbër Salihu)

TRËBST Shtefan (Stefan Troebst) (1955-). Historian gjerman. Lindi në Heidelberg të Gjermanisë. U doktorua në fushën e historisë dhe është njohës i mirë i historisë së Ballkanit. Krahas angazhimit akademik në universitetet më të njohura gjermane dhe europiane,

Ministria e Jashtme e Gjermanisë e emëroi anëtar të misionit afatgjatë të OSBE-së në Maqedoni dhe Moldavi gjatë viteve 1992-1995. Më 1996 u emërua drejtor Qendrës Europiane për Çështje të Minoriteteve (ECMI) në Flensburg. Që nga viti 1999 ishte profesor i Studimeve Kulturore të Europës Qendrore dhe Lindore në Universitetin e Lajpcigut, gjithashtu udhëheqës shkencor i Qendrës për Studime Europiane (GWZO). Ka shkruar artikuj dhe studime për Kosovën dhe vendet e rajonit. Studimeve të tij për Kosovën i janë referuar studiues dhe politikanë që janë marrë me luftërat dhe konfliktet në Ballkan. Vepra e tij më e njohur për çështjen e Kosovës është “Konflikti në Kosovë: Dështimi i parandalimit? 1992-1998” (1998). Ministria e Punëve të Jashtme e Kosovës në vitin 2014 e emëroi Konsull Nderi i Republikës së Kosovës në Lajpcig të Gjermanisë. (Sylë Ukshini)

TROJA. Vendbanim i hershëm në kodrën Hisarlik të fshatit Çanakkala (Turqi). Njihet dhe me emrin Ilion dhe, sipas mitologjisë, u themelua nga Dardani. Vendbanimi shpejt u shndërrua në një qendër të rëndësishme ekonomike, politike dhe kulturore dhe, sipas tij, mori emrin dhe kultura e Trojës e epokës së bronzit në Egje. Meritat për zbulimin e Trojës i takojnë Henrich Shlimanit, i cili refuzoi ta lexonte poemën homerike dhe luftën e Trojës vetëm si legjendë dhe i dha asaj një vlerë gjeografike dhe historike, duke organizuar edhe gërmime arkeologjike (1871-1872). I vetëdijshëm për mungesë të kompetencës profesionale, në gërmimet e mëvonshme (1882) e angazhoi arkeologun gjerman Vilhelm Dorpfeld. Pas ekspeditave arkeologjike (1882-1893), Dorpfeld përcaktoi kronologjinë e vendbanimit me 9 nivele banimi, duke dhënë mendim se niveli VI korrespondonte me Trojën e Homerit. Hipoteza u hodh poshtë nga arkeologu amerikan Karl Blegen (1932), i cili argumentoi se niveli VII (1300-1000), përkatësisht shtresa VIIa i përgjigjet Trojës homerike. Kodra Hisarlik ishte objekt i gërmimeve dhe i studimeve të reja nga viti 1984, nën drejtimin e arkeologut Manfred Korfman (Universiteti i Tubingenit). Gërmimet dëshmuuan se vendbanimi është banuar nga mijëvjeçari IV, Troja I fillonte rreth vitit 2800 p.e.r. dhe se Ilioni antik shtrihej më gjerë se hapësira e kodrës Hisarlik, e cila paraqiste vetëm kështjellën e tij. (Emine Kalaja-Hajdari)

TROKSHI Imzot Pashk (1850-1917). Titullar i Kishës Katolike, argjipeshkëv. Lindi në Mallkuq të Durrësit. Mësimet e para i mori në Laç e Delbnisht, i vijoi më pas në Seminarin Papnor në Shkodër. Studimet e larta për filozofi dhe teologji i vazhdoi në Romë. Pas kthimit në atdhe, shërbeu si famullitar në Gurëz, Kurbin. Në vitin 1892 u emërua argjipeshkëv i Shkupit. Ishte pjesëmarrës në Kuvendin III të Arbërit (Shkodër, 1895). U shqua për nxitjen dhe mbështetjen e arsimit si dhe hapjen e shkollave shqipe në argjipeshkëvinë që drejtonte. Letërkëmbimet me figura të rëndësishme kombëtare dëshmojnë për kontributin e tij në ngjarjet që lidheshin me shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë. Për shkak të këtij aktiviteti pati mosmarrëveshje me Austro-Hungarinë dhe Perandorinë Osmane. Për këtë arsye, P. Trokshi në vitin 1908 i ofroi dorëheqjen Papës Piut X, i cili e ftoi në Romë dhe e emëroi ipeshkëv titullar në ipeshkëvinë Nicolea (Patrikana e Konstandinopojës, Turqi), në krye të së cilës qëndroi deri në fund të jetës. (Sarë Gjegi)

TRONI Alberta (1976-). Pianiste. Lindi në Prishtinë. Kreu studimet universitare në vitin 1997 në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës, dega e muzikës, drejtimi piano, te prof. Lejla Haxhiu-Pula. Studimet pasuniversitare i kreu po aty në vitin 2008. Punën pedagogjike e filloi në vitin 1998, si asistente në lëndën piano në Fakultetin Arteve në Prishtinë, ku tani vazhdon të mbajë mësim. Në vitin 2014 u zgjodh prodekane në Fakultetin e Arteve. Që nga koha e studimeve punoi me pedagogë të njohur, me të cilët mbajti masterklasa. Vlen të përmendet, midis tyre, Jose Ribera. Troni është fituese e vendit të tretë në garat “Nikolai Rubinstain” në Paris (1997). Ka marrë pjesë në festivale vendore, koncertoi me Orkestrën Filarmonike të Kosovës, brenda dhe jashtë vendit, si në Gjermani, Itali, Holandë, SHBA etj. (Rreze Kryeziu-Breznica)



ALBERTA TRONI

TRONI Hilmi (1938-2001). Ekonomist, profesor universiteti. Lindi në fshatin Kovaçec, komuna e Kaçanikut, shkollimin bazë e mori në Kaçanik dhe në Ferizaj, ndërsa studimet i

mbaroi në Universitetin e Prishtinës. Studimet pasuniversitare i kreu në Universitetin e Zagrebit, ndërsa doktoroi në Universitetin e Sarajevës. Në fillim punoi në administratën e komunës së Kaçanikut, në sektorët e planifikimit dhe të ekonomisë, më vonë në Kuvendin e Kosovës, si sekretar i Dhomës Ekonomike, sekretar i Dhomës së Komunave, si dhe drejtor i Institutit Ekonomik. Në vitin 1989 u zgjodh docent në Fakultetin e Bujqësisë, ku ligjëroi lëndën e statistikës aplikative në bujqësi, ndërsa në vitin 1993 zgjidhet profesor i Fakultetit Ekonomik për lëndën bazat e biznesit. Është autor i monografisë së ndërmarrjes “Shari” në Han të Elezit (1986), i një numri të studimeve shkencore të publikuara në të përkohshme të ndryshme ose të lexuara në konferenca shkencore. Është autor i tekstit universitar “Statistika aplikative në bujqësi” (2001). (Ramiz Livoreka)

TRUPAT E MBROJTJES SË KOSOVËS (1999-2009). Forcë civile e uniformuar, trashëgimtare e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e përgatitur për reagim emergjent. Trupat Mbrojtëse të



NJË PARAKALIM I TRUPEVE MBROJTËSE TË KOSOVËS

Kosovës (TMK) u themeluan më 19 shtator 1999, pas demilitarizimit të UÇK-së. Pas përfundimit të procesit të demilitarizimit në shtator të vitit 1999, përfaqësuesi Special i OKB-së Bernard Kushner, nënshkroi Rregulloren nr. 1999/8 për themelimin e TMK-së, e cila më pas u shoqërua me “Deklaratën e parimeve”, të nënshkruar nga komandanti i TMK-së dhe komandanti i KFOR-it. Komandanti i parë i TMK-së ishte, Agim Çeku (1999-2006), ndërsa pas tij, më 2006 u zgjodh komandant Sylejman Selimi. TMK-ja ka pasur gjashtë Zona të Mbrojtjes, Shtabin e Përgjithshëm, Akademinë Ushtarake “Hamëz Jashari”, Kompaninë e

Mjekësisë, Kompaninë e deminimit etj. Në TMK kanë shërbyer 5,052 pjesëtarë të rregullt dhe 800 pjesëtarë rezervë. Demobilizimi i UÇK-së ishte përmendur në një dokument që quhej “Marrëveshja për demilitarizimin dhe transformimin e UÇK-së” e nënshkruar nga NATO-ja dhe UÇK-ja më 20 qershor 1999, menjëherë pas përfundimit të luftës dhe hyrjes së trupave të NATO-s në Kosovë. Ky dokument parashihte që Kosova të ketë një formacion ushtarak, bazuar në modelin e Gardës Nacionale të SHBA-së. Në fakt, modeli i Gardës Nacionale të SHBA-së asnjëherë nuk u aplikua, mirëpo një marrëveshje e mëvonshme i hapi rrugë transformimit të UÇK-së në një forcë civile të uniformuar për reagim emergjent (TMK). Nënshkruet të kësaj marrëveshjeje ishin: Hashim Thaçi, kryeministër i Qeverisë së Përkohshme të Kosovës; Agim Çeku, shef i Shtabit të UÇK-së dhe u pranua nga gjenerallejtnant Majk Xhekson, komandant i KFOR-it. TMK-ja u themelua edhe zyrtarisht më 21 janar 2000, me emërimin solemn të 44 kuadrove të larta. Shumica e stafit komandues të TMK-së ishin ish-luftëtarë të UÇK-së. TMK-ja u formua me mision krejtësisht civil, e ndërtuar në bazë të modelit francez të “Security Civile”. Megjithatë, kosovarët e shihnin si organizatë ushtarake, apo paraardhësen e Ushtrisë së Kosovës, edhe pse kapacitetet e saj ishin të rezervuara. Detyrat dhe të drejtat e TMK-së në atë kohë ishin veprimi për ndalimin dhe zvogëlimin e dëmeve nga katastrofat natyrore dhe aksidentet, ofrimi i ndihmës në zona të rrezikuara, ndihma në pastrimin e fushave të minuara etj. Ndërkohë, Organizata Ndërkombëtare për Migrimin (IOM) mori përsipër procesin e risistemimit të ish-pjesëtarëve të UÇK-së. Ky program përfshiu regjistrimin, demobilizimin dhe riintegrimin e 10,000 luftëtarëve të UÇK-së, qoftë në TMK apo në programe të tjera në jetën civile. TMK-ja u dëshmuar me plotësimin e standardit ndërkombëtar të përcaktuar nga bashkësia ndërkombëtare, i njohur ndryshe edhe si Standardi VIII. Efektivi maksimal i TMK-së ishte 5,000 trupa, prej tyre 3,000 trupa aktive dhe 2,000 trupa rezervë, prej të cilëve 10% e përbënin pakicat, 3.2% pjesëtarë të gjinisë femërore. TMK-ja drejtohej nga Shtabi i Përgjithshëm në Prishtinë, prej të cilit vareshin gjashtë shtabet rajonale. Me dokumentin “Propozimi gjithëpërfshirës për statusin e

Kosovës” i të dërguarit special të OKB-së për Kosovë, Marti Ahtisari, parashihej shpërbërja e TKM-së dhe krijimi i një force të re. Mbi bazën e këtij dokumenti, më 20 janar 2009 TMK-ja zyrtarisht u shndërrua në Forcën e Sigurisë së Kosovës. (Sylë Ukshini)

TRUSTI I KURSIMEVE PENSIONALE TË KOSOVËS. I njohur edhe si Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës (FKPK), është person juridik i pavarur nën mbikëqyrjen e Bankës



TRUSTI PENSIONAL I KOSOVËS

Qendrore të Kosovës (BKQ), i themeluar me qëllimin të administrimit dhe menaxhimit të llogarive individuale për pensionet e bazuara në kursime, në investim të kujdesshëm dhe për të ruajtur ose për të rritur vlerën e llogarive individuale të bazuara në kursime. Është një administrues i besueshëm që vepron në emër të pjesëmarrësve dhe shfrytëzuesve. Aktivitetet e Trustit udhëhiqen nga bordi drejtues, i përbërë prej 8 anëtarësh, të cilët emërohen nga Kuvendi i Kosovës. Trusti është përgjegjës për investimin e këtyre kursimeve në tregun e letrave me vlerë dhe në forma të tjera, me qëllim të përfitimeve për kursimtarët, për të cilët ata janë një fond mirëbesimi. Propozimet për investime bëhen nga specialistët që njihen si menaxherë të aseteve, të cilët janë licencuar nga BQK-ja ose nga ndonjë organ tjetër rregullues i tregut të kapitalit në Kosovë (ose trashëguesi i tij), apo nga një organ i tregjeve të kapitalit të shteteve anëtare të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD). Mjetet e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës investohen vetëm në pajtim me dispozitat ligjore dhe me qëllim të rritjes së fitimit në investim, vetëm në interes të pjesëmarrësve dhe të shfrytëzuesve. Përreth

12 vjet vlera e kursimeve personale është rritur rreth 20% në kohën kur këto kursime kanë arritur mbi 1 miliard euro. Administrata Tatimore e Kosovës ka përgjegjësi dhe të drejta të njëjta lidhur me inspektimin, vlerësimin dhe zbatimin e pagesave të kontributeve që ajo i ka rreth tatimit në të ardhura. Kjo, pa kufizime, përfshin të drejtën për vlerësimin e denimeve, shtimin e mjeteve, kontrollimin e shënimeve dhe të gjitha kompetencat e tjera zbatuese, që i janë dhënë në pajtim me ligjin në fuqi. Nëse pjesëmarrësi në kursimet e Trustit vdes para moshës së pensionit, shuma në llogarinë e pjesëmarrësit i paguhet përfituesit apo shfrytëzuesve, përkatësisht trashëgimtarëve. (Ymer Havolli)

TUBERKULOZI. Është sëmundje ngjitëse, me dekurs kryesisht kronik, që shkaktohet nga "bacili i Kohut", prek mushkëritë ose ndonjë organ tjetër si: veshkat, kockat, trurin, kyçet, cipat e mushkërive, të barkut, zembrës dhe trurit, sytë, lëkurën, nyjat limfatike, mëlçinë etj. Deri në zbulimin e vaksinës kundër tuberkulozit në vitin 1919, sëmundja shkaktonte shumë vdekje në botë. Tuberkulozi është sëmundje e përhapur në gjithë botën. Në të kaluarën ishte i përhapur kryesisht në vendet e varfra dhe në zhvillim, ndërsa sot sëmundja regjistrohet edhe në vendet e zhvilluara, si pasojë e lëvizjeve të mëdha të popullsisë dhe të ndërprerjes së vaksinimit në shumë shtete. Rruga më e shpeshtë e përhapjes së sëmundjes është përmes spërklave, që janë përplot bacile. Sëmundja rrallë fillon në formën akute, kryesisht ka dekurs kronik, me çrast shenjat paraqiten pas disa muajve dhe viteve. Te një numër i të infektuarve nuk shfaqen shenjat klinike (tuberkulozi latent), të cilët nga aspekti i shëndetit publik paraqesin një grup të rrezikshëm, sepse e përhapin sëmundjen pa u vërejtur se janë të infektuar. Në Kosovë për parandalimin e tuberkulozit aplikohet vakcina BCG, ndërsa për trajtimin e sëmundjes jepen tuberkulostatikë të rendit të parë dhe të dytë. Vaksinimi kundër kësaj sëmundjeje në Kosovë është aplikuar pas Luftës së Dytë Botërore (1947-1948). Një kohë të gjatë në Kosovë janë regjistruar një numër i madh i rasteve të prekur nga tuberkulozi. Vetëm në periudhën 1988-1997 janë sëmurë 8,763 persona me 89 të vdekur. Në periudhën 2004-2014 janë regjistruar 10,502 raste, ndërsa nga

viti 2006 (1,122 raste, ose 53 raste në 100,000 banorë) vërehet rënie e numrit (834 raste ose 46.1 në 100,000 banorë (2014). Ky numër i të sëmurëve është ende i lartë, krahasuar me vendet e tjera në Europë dhe rajon. Në Kosovë, që nga viti 2000 për kontrollin e tuberkulozit implementohet programi DOTS, i cili fillimisht ishte iniciativë e “Mjekëve të Botës”, më pas u bë pjesë e strategjisë kombëtare. Rezultatet e këtij programi vërehen më tepër pas vitit 2006 kur filloi të bjerë numri i rasteve. Menaxhimi i kësaj sëmundjeje në Kosovë bazohet në Programin Kombëtar të Tuberkulozit, i cili koordinohet nga Ministria e Shëndetësisë, ndërsa implemenitimi i aktiviteteve realizohet nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik, Klinika e Pulmologjisë me spitalet rajonale. (Ariana Kalaveshi)

TUBIMET E GAZIMESTANIT (1939, 1989). Tubime të nacionalistëve serbë në Gazimestan, për të shënuar 550-vjetorin dhe më pas 600-vjetorin e Betejës së Kosovës. Në tubimin e 550-vjetorit u mbledhën rreth 100,000 vetë, gjatë të cilit argjipeshkvi i Ohrit dhe Zhicës, Nikolaj Velimiroviq e deklaroi Kosovën tokë të shenjtë të serbëve. Ky diskurs serb nxiti sulmet e çetnikëve kundër shqiptarëve në Kosovë dhe Sanxhak në prag të Luftës së Dytë Botërore dhe përgjatë saj. Ripërtëritja e mitit të Kosovës shkaktoi armiqësi të mëtejshme ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve në Kosovë dhe më gjerë. Serbët vazhduan ta konsideronin Kosovën si tokë serbe të pushtuar nga shqiptarët dhe mobilizuan nacionalizmin serb mbi “të drejtën historike” të Serbisë mbi Kosovën. Me të njëjtin diskurs Slllobodan Millosheviq mbajti një fjalim me tone nacionaliste më 28 qershor të vitit 1989, me rastin e shënimit të 600-vjetorit të Betejës së Kosovës, ku ishin mbledhur rreth 300,000 serbë. Ky fjalim i Millosheviqit u cilësua si hyrje në luftërat që më pas shpërthyen pothuajse në tërë hapësirën e ish-Jugosllavisë. Fjalimi i tij luftënxitës u konsiderua si pika më e lartë e ashpërsimit të marrëdhënieve shqiptaro-serbe në Jugosllavi, para se të fillonte konflikti i hapur luftarak në fund të viteve '90. (Mrika Limani)

TUCOVIQ (Tucović) Dimitrije (1881-1914). Socialdemokrat serb. Lindi në fshatin Gostile në rrethin e Zllatiborit, në Serbi. Që kur ishte student u përfshi në radhët e lëvizjes punëtore



DIMITRIJE
TUCOVIQ

dhe të socialdemokracisë serbe. Më 1902 ishte organizator i demonstratave të studentëve kundër Nikolla Pashiqit dhe më pas i demonstratave të marsit të vitit 1903, kundër Aleksandër Obrenoviqit. Pas kësaj kaloi në ilegalitet dhe u strehua në Zemun dhe më vonë në Vjenë. Pas grushtit të shtetit të majit të vitit 1903 dhe ardhjes së Karagjorgjeviqëve në pushtet u kthye në Beograd dhe mori pjesë aktivisht në themelimin Partisë Socialdemokrate Serbe. Ishte redaktor i revistës “Radniçe novine”, në të cilën shkruhej për gjendjen e rëndë të klasës punëtore dhe të fshatarësisë serbe. Më 1906 përfundoi studimet në Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Beogradit. Si sekretar i Partisë Socialdemokrate Serbe botoi revistën “Borba” (1910). Ishte pjesëmarrës në shumë kongrese dhe konferenca të socialdemokratëve europianë. Në vitin 1912 mori pjesë në luftërat ballkanike dhe, si i mobilizuar në ushtrinë serbe, ishte i përfshirë në ekspeditat e saj në trevat shqiptare deri në pushtimin e Elbasanit. Në librin “Serbia dhe Shqipëria” ai kritikoi ashpër politikën ekspansioniste të borgjezisë serbe ndaj tokave shqiptare. Ndërkaq, kur ushtria serbe kishte hyrë në Gjakovë, ai kishte shkruar: “Kemi hyrë në një tokë të huaj”. Duke qenë dëshmitar i masakrave mbi popullsinë shqiptare në viset e pushtuara, thoshte se kjo ishte një “vrasje me paramendim” mbi një popull të tërë dhe se për këtë vepër kriminale një ditë do të paguhet një çmim. Me fillimin e Luftës së Parë Botërore u mobilizua sërish në radhët e ushtrisë serbe dhe u vra në Betejën e Kollubarës. (Isa Bicaj)

TUDA Rahmi (1934-2003). Shkrimtar, mbledhës dhe studiues i folklorit. Lindi në Velestë të Strugës. Kreu Shkollën Normale në Shkup dhe studioi për filozofi. Në Universitetin e Prishtinës kreu studimet pasuniversitare dhe mbrojti disertacionin nga fusha e letërsisë (1990). Për shumë vjet punoi në arsim. Në vitet 1994-1998 ishte dekan i Fakultetit Filozofik të Universitetit të Tetovës. Në këtë universitet ka ligjëruar për letërsi gojore dhe filozofi. Është autor i një sërë veprash letrare për fëmijë dhe të rritur, si dhe i disa veprave nga fusha

e studimeve folkloristike. Ishte mbledhës i poezisë dhe i prozës popullore në rrethinën e Strugës. Ka botuar veprat me poezi: “Kah dita” (1965), “Kronika e stinëve” (1965), “Juve ju këndoj” (1971), “Zgjime” (1972), “Vallja e lumit” (1984), “Pulëbardhat fluturojnë” (2001), “Metafora e kurmit” (2001), si dhe monografitë studimore “Vlerat estetike të poezisë sonë legjendare” (1993), “Çështje paremiologjike” (1994) “Vlerësime folklorike” (1998) “Larmia e disa formave dhe motiveve folklorike” (2000) etj. (Zymer U. Neziri)

TUFEKXHI Fevzi (1948-) Grafist. Lindi në Prizren. Kreu Shkollën e Lartë Pedagogjike, degën e artit figurativ në Prishtinë (1970), ndërsa Akademinë Kombëtare të Arteve të Bukura për Pikturë dhe Grafikë në Stamboll (1975). Hapi ekspozita personale në Shkup, Prizren, Stamboll dhe Mitrovicë. Gjithashtu mori pjesë në bienalet grafike në Krakovë, Stamboll, Ankara, Sint Niklass, Belgjikë, në Tuzëll dhe në ekspozitat kolektive në Prizren, Prishtinë, Ankara, Vjenë, Londër, Gllasgou, Malmo, Belfast, Izmir, Odesa, Paris etj. Është shpërblyer në Kosovë e në Turqi. Nga viti 1992 jep mësim në Universitetin e Arteve të Bukura “Mimar Sinan” në Stamboll. (Basri Mekolli)

TUHINA Gjeraqina (1975). Gazetare. Lindi në Prishtinë. Shkollimin fillor, të mesëm dhe studimet në Fakultetin Juridik i përfundoi në Prishtinë. Në vitin 1996 filloi punë në të përjavshmen “Koha”, për të kaluar një vit më vonë në të përditshmen “Koha ditore”. Ishte raportere e Radios “Evropa e Lirë” nga Prishtina. Në këtë periudhë bashkëpunoi me revistën mujore të Institutit të Raportimit mbi Luftën e Paqen (IWPR). Për portalin e këtij instituti botoi ditarin anonim gjatë periudhës së bombardimeve të NATO-s, ndërsa përshkrimet janë marrë në gazetën ditore në Europë si ndër burimet e rralla nga terreni, ku gazetarët e kishin të ndaluar punën profesionale. Pas çlirimit të Kosovës punoi në zyrën e agjencisë amerikane Associated Press në Prishtinë, ndërsa nga viti 2000 punon korrespondente nga Brukseli për Radion “Evropa e Lirë” dhe Radiotelevizionin e Kosovës. (Besim Abazi)

TUMA E BANJËS SË PEJËS. Vendvarrim tumular i epokës së hekurit. Gjendej në qendër të Banjës së Pejës dhe u zbulua rastësisht para

veprimeve përfundimtare të ndërtimit të objektit hotelier, pas konstatimit se në të ishte zbuluar një përkrenare ilire. Gërmim-shpëtimi u zhvillua në vitin 1974 nga Muzeu i Kosovës. Megjithëse konstruksioni tumular ishte rrafshuar, u konstatua se është fjala për tumë princore dhe u gjet varri çift i aristokracisë fisnore, të mashkullit dhe femrës. Varri kishte bazë drejtkëndore dhe ishte i shtruar me pllaka shtufi. Inventari i tij përbëhej nga tri përkrenare ilire prej bronzi, stoli argjendi, armë e maje shigjetash trefletëshe, enë të importuara me figura të zeza (olpa, kiliksë) dhe qeramikë dyvegjake të prodhimit lokal. Varri femëror karakterizohej me stoli argjendi: fibula, gjilpëra në formë omegë, unazë dhe byzylykë të zbukuruar me motive gjeometrike e sumbulla, ndërsa varri mashkullor karakterizohej me pajisje ushtarake. Tuma i takon tipit të varreve princërore të shek. VI-V p.e.r., të ngjashme me tumat e pasura ilire të Ateniçës dhe Novi Pazarit (Serbi). (Sedat Barajliu)

TUMA E CERNICËS. Varr tumular i periudhës romake. Gjendet te hapësira me mikrotoponim “Cernica”, në perëndim të Ulpianës antike. Gjysma e tumës u gërmua në vitin 1987 nga Universiteti i Prishtinës dhe, në bazë të fragmenteve të qeramikës, u datua në shek. II-III. Tuma ka diametër prej rreth 40 m dhe duket se kishte varr qendror, si në rastin e tumës në “Fushën e Çerkezit”. Paraqitja e varrimit në tuma shpreh rikthim në traditat e mëhershme gjatë periudhës romake. (Sedat Barajliu)

TUMA E FUSHËS SË ÇERKEZIT. Varr tumular i periudhës romake. Gjendet te toponimi “Fusha e Çerkezit” të Graçanicës, në veri të Ulpianës, në anën e djathtë të lumit Graçanka. Tuma kishte diametër prej 40 m. Hulumtimet i zhvilloi D. Srejoviq. Në të u zbulua vetëm një varr shumë i pasur femre, me konstruksion tullash, i mbuluar me pllaka guri. Tuma u datua në shek II-III, ndërsa mendohet se varri bën pjesë në tipin e varreve Mala Kopashnica-Sase, që është mënyrë e veçantë e varrimit në Dardaninë Perëndimore gjatë periudhës romake. Tuma të ngjashme janë hulumtuar nga E. Shukriu në hapësirën me mikrotoponim “Cernica”, në perëndim të Ulpianës (Universiteti i Prishtinës, 1987) dhe te Komorani (Muzeu i Kosovës, 1975). Paraqitja e varrimit në tuma shpreh rikthim në

traditat e mëhershme gjatë periudhës romake. (Sedat Barajliu)

TUMA E JASHANICËS. Varr tumular në fshatin Jashanicë, rreth 6 km në verilindje të Klinës, në anën e djathtë të rrugës Skënderaj-Klinë. Ndonëse e dëmtuar nga punimet bujqësore, përmasat e saj dëshmojnë se është ndër tumat më të mëdha në Kosovë (50 x 40 x 5 m). Gërmime arkeologjike nuk janë zhvilluar, por gjetja e rastit të një maje heshte prej bonzi në trajtë flake (2012) sjell në përfundim se tuma mund t'i takojë periudhës së bronzit të vonë. Në përfundim të tumës gjendet kodra me toponimin "Gradina e Roganeve". (Premtim Alaj)

TUMA E MOGLICËS. Varr tumular i epokës së hekurit. Gjendet rreth 300 m në veri të rrugës Gjakovë-Raçe dhe 200 m në jug të lumit Erenik. Mban toponimin "Vorret e shkreta". Ka diametër të ruajtur prej 22 m dhe lartësi 1.50 m. Është e ndërtuar kryesisht me dhë. Rreth 30 m në jug të saj gjendet dhe pjesa e poshtme e një tume tjetër, shtresat e sipërme të së cilës janë shkatërruar nga punimet bujqësore. U gërmua nga Instituti Arkeologjik në vitin 2002. (Sedat Barajliu)

TUMA. Vendvarrim në trajtë kodre artificiale gjysmësferike. Tuma është ngritur për varrimin e personit tejet të nderuar të fisit ose bashkësisë fisnore. Në të, njëkohësisht ose më pas, janë vendosur dhe varre të tjera, me drejtim kah varri qendror. I ndjeri vendosej në varrin qendror kryesisht në taban. Varrin në qendër kufizohej gjerësisht me unazë rrethore, që ishte mur i ngritur kryesisht prej gurësh të lumenjve (diametri 10-40 m). I gjithë konstruksioni arkitektonik mbulohej me dhë e gurë ose vetëm me dhë. Varret kanë kryesisht trajtë katërkëndëshe dhe janë ndërtuar nga gurë ose pllaka guri të vendosur vertikalisht. Në përgjithësi, varret nuk kanë mbulesë prej gurësh. Varrimi në tuma njihet kryesisht nga epoka e bronzit të hershëm dhe si traditë ngeli gjatë epokës së hekurit, rrjedhimisht deri në shek. IV p.e.r. Në mesin e tumave më të njohura të Kosovës janë ato të Romajës, Rogovës, Shirokës etj. Tradita e varrimit në tuma u rikthye gjatë shek. II-III, siç dëshmohet nga tuma te "Arat e Çerkezit" dhe "Cernica" tek Ulpiana dhe ajo e Komoranit. Gllasinacit

te Sarajeva përmban numrin më të madh të tumave të epokës së bronzit dhe të hekurit, andaj dhe sipas tij u quajt kultura e Gllasinacit, e përhapur gati në gjithë territorin ilir. (Sedat Barajliu)

TUMAT E DUBIÇAKUT. Vendvarrim tumular i epokës së hekurit, i përbërë nga tetë tuma. Gjendet në tarracën përballë Shirokës, në krahun e djathtë të rrugës Suharekë-Prizren. Në vitin 1963 u gërmuan nga Muzeu i Kosovës tri tuma. Tuma I kishte diametër prej 12 m, lartësi 0.41 m dhe përmbante dy varre me konstruksion gurësh, me trupvënie. Nuk kishte inventar. Tuma II kishte diametër prej 24 m, lartësi 0.71 m dhe ishte e shkatërruar nga varrimet mesjetare dhe punimet bujqësore. Tuma III kishte diametër prej 12 m dhe përmbante tetë varre me konstruksion gurësh në trajtë drejtkëndëshe dhe kishte inventar enësh qeramike dhe armë hekuri. Riti i varrimit ishte trupvënia. Tumat datohen në fazën e zhvilluar të periudhës së hekurit dhe i takojnë kompleksit të kulturës së Gllasinacit. (Sedat Barajliu)

TUMAT E LUBOZHDËS. Varreza tumulare të epokës së bronzit dhe të hekurit. Gjenden në Lubozhdë, rrëzë malit Mokna, rreth 4 km në perëndim të Istogut. Në vitet '70 të shek. XX janë gjetur dy stoli argjendi gjatë punimeve bujqësore dhe më 2012, gjatë hapjes së një kanali, janë gjetur disa armë, fragmente të qeramikës dhe kocka. Në vitin 2014 Instituti Arkeologjik i Kosovës gërmoi dy tuma, një në lagjen Kadaj dhe një në lagjen Pepaj, të cilat i përkasin kulturës së Gllasinacit. Tuma në lagjen Kadaj (12 x 10 x 0.4 m) kishte gjashtë varre të dëmtuara, me rit të trupvënies dhe inventar të varfër të shek. VI-IV p.e.r., prodhime lokale dhe importe. Tuma në lagjen Pepaj (20 x 16 x 1.95 m), e dëmtuar nga punimet bujqësore, kishte mbi 40 varre dhe përfaqëson tumën me më së shumti varre të zbuluara në Kosovë. U ndërtua me dhë dhe gurë gëlqerorë vendorë (5-40 cm), që shërbyen për konstruksione dhe mbulesa të varreve. Rit ishte trupvënia, por përmbante dhe varre me trupdjegje. U ndërtua mbi varrin qendror të bronzit të hershëm dhe u përdor në epokën e bronzit të vonë dhe të hekurit, ndërsa një varr i takon antikitetit të vonë. Inventari i pasur përbëhej nga prodhimet vendore dhe të importit. (Premtim Alaj)

TUMAT E LLASHTICËS. Vendvarrim tumular i epokës së hekurit. Përbëhet nga 9 tuma, të cilat gjenden buzë përroit Llashtica dhe rrëzë vargmaleve të Karadakut, 10 km në verilindje të



VENDVARRIM TUMULAR NË LLASHTICË

Gjilanit. Tumat kanë formë kupole gjysmësferike me diametër 7-36 m dhe lartësi 0,70-2, 20 m dhe i përkasin shek. VIII-VII p.e.r. Janë ndërtuar nga dheu dhe kishin bazë fillestare muranën qendrore prej gurësh dhe unazën e ruajtur me 1-2 rreshta gurësh. Mënyra e varrimit i takon rritit të varreve me djegie, me hi të vënë drejt mbi taban (Tuma VIII). Dy tuma janë shfrytëzuar edhe për varrime gjatë mesjetës (Tumat I, IV). Gërmimet u zhvilluan nga Muzeu i Kosovës (1980-1982) dhe Instituti Arkeologjik i Kosovës (2011, 2012). (Kemajl Luci)

TUMAT E PËRÇEVËS. Nekropol tumular i epokës së hekurit. Gjendet në vendin e quajtur "Boka" afër fshatit Përçevë të Klinës. Në të janë evidentuar 19 tuma, të vendosura në grupe prej 3 tumash, në distancë deri në 300 m. Muzeu i Kosovës i hulumtoi 7 tuma në vitet 1973-1975. Riti i varrimit në to ishte me trupvënie. Të dhënat më të hershme kronologjike janë regjistruar në tumën XIV, e cila kishte diametër prej 18 m, lartësi 1 m dhe përmbante 24 varre me konstruksion guri. Në tre tuma janë vendosur më vonë dhe skelete mesjetare. Tumat i përkasin grupit kulturor të Gllasinacit. Pas përnjohjes arkeologjike të Institutit Arkeologjik janë evidentuar gjithsej 49 tuma. (Sedat Barajliu)

TUMAT E PORODIMES. Varrezë e epokës së hekurit, e përbërë nga tetë tuma. Tumat janë vendosur rrëzë Kodrës së Madhe afër fshatit Porodime, 3 km në të djathtë të rrugës

Shtime-Ferizaj. Hulumtimet arkeologjike u zhvilluan nga Muzeu i Kosovës në tri tuma (1976), të cilat kishin konstruksione të traditës ilire, me unaza rrethore prej gurësh lumi dhe me konstruksione të varreve. Tumat kishin diametër prej 8-14 m. Unaza rrethore është ruajtur në tërësi vetëm në Tumën IV, ndërsa në Tumën VI dhe VII janë dëmtuar nga lëvrimi i fushës. Varrimi është zhvilluar në dy faza, faza I i takon shek. VIII-VII dhe faza II shek. VI-IV. Inventari përbëhet nga stoli dhe enë qeramike dardane, përfshirë dhe zbukurimin me rrotëz të dhëmbëzuar. Në mesin e stolive spikaten trokveset e përdredhura prej bronzit dhe fibulat me zbukurime sferike në hark. (Edi Shukriu)

TUMAT E ROGOVËS. Vendvarrim tumular i epokës së bronzit dhe të hekurit. Përbëhet nga gjashtë tuma dhe gjendet te mirkotoponimi me emrin "Fusha" në Rogovë. Tumat u ndërtuan në epokën e bronzit të mesëm dhe në epokën e hekurit. Disa u shfrytëzuan për varrim edhe gjatë mesjetës. Riti i varrimit u bë me trupvënie, por ka raste edhe të trupdjegies. Varret janë ndërtuar me konstruksione prej gurësh në trajtë katërkëndëshi të zgjatur, me orientim veri-jug dhe lindje-perëndim. Inventari i varreve përbëhet nga armë, vegla, stoli dhe qeramikë, të cilat i përkasin kompleksit kulturor të Gllasinacit. U hulumtuan nga Muzeu i Kosovës (1966, 1973, 2004, 2011). (Kemajl Luci)

TUMAT E SHIROKËS. Nekropol tumular, i përbërë nga tetë tuma. Gjendej te fshati Shirokë, 1.5 km më jug të Suharekës. Në të djathtë të rrugës Suharekë-Prizren ishin dy tuma, ndërsa në anën e majtë dy grupe me nga tri tuma. Gërmimet arkeologjike u kryen vetëm në dy tuma në vitin 1963 (Muzeu i Kosovës) dhe rezultatet u botuan në Buletinin e Muzeut të Kosovës. Tuma I kishte diametër prej 13 m, lartësi 0.75 m dhe përmbante pesë varre me djegie, me inventar enësh qeramike dhe stoli bronzit. Tuma II kishte diametër 12 m, lartësi 0.75 m dhe përmbante gjashtë varre me djegie, me inventar enësh qeramike dhe armësh hekurit. Në tumën II janë ruajtur dhe pjesë të unazës rrethuese. Të dy tumat kishin një shtresë të trashë hiri në pjesën qendrore dhe datohen në shek. VII-VI p.e.r. (Halshtat C). (Sedat Barajliu)

TUMAT E VOLLJAKËS. Varreza tumulare ilire të epokës së bronzit dhe të hekurit. Janë

evidentuar 42 tuma, që shtrihen në perëndim të Volljakës, komuna e Malishevës. Tumat janë vënë përgjatë vijës kurrizore të masivit shkëmbor dhe në shpatet e tij, duke lënë përafërsisht në mes vendbanimin parahistorik. Tumat kanë përmasa të ndryshme (diametër 5-30 m, lartësi 0.20-2 m). Pas gërmimeve të 4 tumave nga Instituti Arkeologjik i Kosovës (2012, 2013) u konstatua se këto janë ndërtuar me shumë gurë të terrenit dhe me pak dhë, se disa kishin unazë rrethore, se kishte dhe dy varre me djegie të vendosura në urna dhe se nekropoli tumular u ndërtua në epokën e bronzit të mesëm dhe vazhdoi edhe gjatë epokës së hekurit. Nekropoli i takon grupit kulturor iliro-dardan (varianti Mat-Gllasinac) dhe pas atij të Përçevës është më i madhi për nga numri i tumave. Gjatë hulumtimit të tumave u bënë dhe gërmime sondazh në vendbanimin parahistorik të Volljakës dhe të Përçevës, me ç'rast u vendos lidhja e vendbanimit me nekropolin. (Shafi Gashi)

TUMB Albert (Thumb) (1865-1915). Indo-europianist, gjuhëtar gjerman. Lindi në Freiburg. Studioi gjuhësi indoeuropiane në Freiburg, në Lajpcig dhe në Hajdelberg. U promovua në gjuhësi krahasimtare dhe filologji klasike në Frajburg. Studioi greqishten moderne dhe mori provimin shtetëror për filologji klasike. Pas udhëtimit studimor në Greqi, botoi “Doracak i greqishtes së re popullore” (Handbuch der neugriechischen Volkssprache, 1910). Punoi si mësues i gjuhësisë krahasuese dhe i gjuhësisë moderne greke në Freiburg dhe profesor i gjuhësisë moderne greke në Universitetin e Frajburgut. Në një udhëtim të dytë në Lindje (1894), mblodhi material nga folklori grek dhe nga greqishtja moderne. Më 1901 u zgjodh profesor në Marburg dhe më 1909/1910 u emërua profesor i gjuhësisë krahasimtare në Universitetin e Strasburgut. Studimet e tij përfshijnë probleme në gjuhësi sasiore, në gjuhësi të përgjithshme, në gjuhësi indoeuropiane dhe në gjuhësi moderne e folklor grek. Problemet e shqipes ai i vështrroi kryesisht në kuadër të këtyre disiplinave, sidomos në studimin “Elementet lashtogreke të shqipes” (Altgriechische Elemente des Albanesischen, 1910). Ishte ndër të parët që elementet e vjetra greke në gjuhën shqipe i konsideron më të hershme se ato latine. Sipas tij, në shqipen ndeshen 21 fjalë nga greqishtja

e vjetër, si: *drapën/drapër, lakën/lakër, pjepën/pjepër, presh, qersh, shpellë* etj. (Shpëtim Elezi)

TUNMAN Johan Erik (Johann Erich Thunman) (1746-1778). Gjuhëtar suedez, historian, teolog dhe albanolog. Profesor i filozofisë në Universitetin e Halles. Është i pari që studioi, argumentoi dhe botoi në nivel akademik ndërkombëtar tezën për prejardhjen ilire të shqiptarëve. Në veprën “Hulumtime për historinë e popujve të Europës Lindore” (Lajpcig, 1774), e cila ruan ende vlerën e saj, Tunman bëri përpjekjen e parë shkencore për të shpjeguar prejardhjen e shqiptarëve dhe të gjuhës së tyre dhe të rumunëve (vllahëve). Në bazë të argumenteve të nxjerra nga burimet greko-latine e bizantine, arriti në përfundimin se shqiptarët mesjetarë janë vazhduesit autoktonë të popullsisë antike të ilirëve, që nuk u romanizua si ajo dako-trake, paraardhëse e rumunëve, as nuk u zëvendësua në viset e veta nga një popullsi e mëvonshme e dyndur këtu. Duke u mbështetur në burimet bizantine, ai jep historinë e shqiptarëve mesjetarë si një formacion etnokulturor unitar dhe si faktor politik më vete. Si provë të gjuhës së këtij populli, Tunman përfshiu në këtë vepër fjalorin e Th. Kavalotit. Hulumtoi origjinën e termit “shqiptar”, që njihet si emri etnik i tyre. Besoi në unitetin iliro-trak. Me gjithë gjendjen ende të pazhvilluar të studimeve ballkanike në atë kohë, vepra e Tunmanit përbën një ndihmesë për të vënë mbi baza shkencore problemin e formimit të popullit shqiptar dhe të gjuhës së tij. (Mensur Vokri)

TUPALLA. Vendbanim rural i tipit të dendur, 4 km në juglindje të Medvegjës. Shtrihet në anët lindore të luginës së Jabllanicës, në lartësi mbidetare 710 m. Sipërfaqja e territorit të fshatit është 1,378 ha. Në vitin 1961 Tupalla kishte 1,145 banorë, ndërsa në vitin 2002 ajo shënon rënie në 880 banorë. Popullsia e këtij fshati, si dhe e fshatrave të tjera shqiptare të kësaj zone është shpërngulur në drejtim të qendrave urbane të Kosovës, para së gjithash në Gjilan dhe në Prishtinë me rrethinë. Ky proces vazhdon edhe tani, duke rrezikuar shpopullimin dhe boshatisjen e tërësishme të fshatrave shqiptare në këto anë. Nga objektet e standardit shoqëror funksionon shkolla fillore në gjuhën shqipe, e cila është para mbylljes, për shkak të mungesës së nxënësve. (Arsim Ejupi)

TURANO Xhusepina (Giuseppina) (1961-). Gjuhëtare arbëreshe, profesore. Lindi në S. Nikola del'Alto, në Kalabri. U diplomua për gjuhë dhe letërsi të huaja në Firencë (1989), ndërsa doktoroi për albanologji në Universitetin e Kalabrisë (1994). Prej vitit 1997 punon si mësimdhënëse universitare, fillimisht në Universitetin e Kalabrisë (1997-2002), pastaj në atë të Firences, ndërsa prej vitit 2002 punon në Universitetin e Venecies. Merret me gjuhësinë shqipe dhe me dialektologjinë arbëreshe, duke shfrytëzuar metodën gjenerative. Është autore e librave dhe e artikujve që eksplorojnë strukturat morfosintaktike të shqipes dhe të dialekteve italo-shqiptare. Merret gjithashtu me kontaktet gjuhësore, me dygjuhësinë, me shumëgjuhësinë në dialektet arbëreshe, me fenomene të ndërhyrjes së italishtes në strukturat sintaksore të varieteteve italo-shqiptare. Përveç sintaksës është marrë edhe me analiza filologjike, me metodat e përkthimit të teksteve letrare shqipe në italisht, me studime kulturore, me fokus të veçantë në marrëdhëniet ndërmjet kulturës arbëreshe dhe italiane dhe me studime letrare. Ndër botimet e saj veçohen: “Hyrje në gramatikën shqipe”, (Introduzione alla grammatica albanese, 2004), “Veçori gjuhësore dhe kulturore të Arbërisë Krotoneze” (Tratti linguistici e culturali dell’Arberia Crotonese, 2001) etj. Në bashkëpunim me F. Kolecin ka hartuar “Hyrje në sintaksën gjenerative të shqipes” (2011) dhe, me R. Memushajn dhe F. Kolecin vëllimin “Studime teorike dhe empirike të sintaksës shqipe” (Theoretical and Empirical Studies in Albanian Syntax, 2012). (Lindita Rugova)

TURÇELI. Emërtim për banorët me origjinë shqiptare që flasin turqisht në një komunitet shqiptar. Turqishtja në shumë vendbanime në Kosovë ka qenë shënjesues i statusit social. Në vendbanime si Prizreni, Gjilani, Prishtina, Peja, Vushtrria, por edhe në vendbanime të tjera të ish-Vilajetit të Kosovës në kuadër të Perandorisë Osmane, para vitit 1912, si Shkupi, e Tetova, banorët etnikë shqiptarë që kanë shprehur identitetin qytetar, kanë folur në shtëpi turqishten. Gjatë viteve pesëdhjetë ish-Jugosllavia e ka shpërngulur në Turqi një pjesë të këtij komuniteti. Fjala turqeli në mesin e shqiptarëve ka edhe konotacion negativ. (Imri Badallaj)

TURIQECI. Fshat në Drenicë, rreth 12 km në jugperëndim të Skënderajt. Lartësia mbidetare

566 m. Është vendbanim i tipit të shpërndarë me sipërfaqe rreth 663 ha. Nëpër fshat kalon rruga magjistrale Skënderaj-Klinë, që i mundëson lidhje të mira komunikuese me këto qendra dhe qendrat e tjera të Rrafshit të Dukagjinit. Është vendbanim i vjetër, që dëshmohet nga gjetjet dhe mbishkrimet e vjetra arkeologjike në territorin e fshatit. Si vendbanim përmendet në dokumentet e shkruara mesjetare. Në vitin 1921 Turiqeci kishte 159 banorë, në vitin 1948 kishte 367 banorë, ndërsa në regjistrimin e fundit (2011) kishte 557 banorë. Banorët merren me bujqësi dhe blegtori. Kultivohen drithërat, bimët foragjere, pemët etj. Është qendër e bashkësisë lokale, në të cilën gravitojnë vendbanimet: Burojë, Kopiliq i Epërm, Kopiliq i Poshtëm dhe Vojnikë. Me planin zhvillimor komunal avancohet në nënqendër urbane edhe për vendbanimet Kodërnik (Kllodernicë) dhe Izbicë. Ka shkollën 9-vjeçare, qendrën shëndetësore, qendrën e veterinarisë, njësi tregtare etj. (Ramiz Cërvadiku)

TURIZMI DIMËROR. Në kuptimin më të ngushtë bën pjesë në turizmin sportiv, ndonëse në kuadër të eksperiencave bashkëkohore turistike është pjesë e turizmit të aktiviteteve



OBJEKTE TURISTIKE NË BOGË, RUGOVË

në natyrë. Kryesisht nënkupton aktivitetet në natyrë gjatë stinës së dimrit, sportet dimërore me ski ose skiboard, ngjitjen ose ecjen mbi borë, vrotimin dhe ndihmën me ushqime të kafshëve të egra, si dhe forma të tjera të rekreacionit në natyrë në sezonin e dimrit. Falë terreneve të përshtatshme si dhe cilësisë dhe qëndrimit të borës gjatë dimrit, Kosova potencialisht ka resurse të cilësisë së lartë dhe qëndron në nivelet më të larta në mesin e vendeve të rajonit dhe të Europës Juglindore, sidomos bjeshkët

e Deçanit, të Junikut, të Pejës dhe të Istogut, në kuadër të Bjeshkëve të Namuna; bjeshkët e Lubotinit, të Brezovicës, të Prevallës, të Zaplluxhës, të Brodit dhe të Restelicës, në kuadër të sistemit të Sharrit, si dhe bjeshkët e Shalës së Bajgorës, në kuadër të sistemit të bjeshkëve të Kopaonikut. Turizmi dimëror është zhvilluar në mesin e viteve '70 të shekullit XX vetëm në Brezovicë, falë atraktivitetit, infrastrukturës, por edhe të rrethanave politike të kohës. Bjeshkët e tjera kanë mbetur jashtë valorizimit turistik, në mungesë të investimeve elementare në infrastrukturën publike. Gjatë dekadës së fundit janë bërë disa përpjekje pioniere në nivel krejtësisht fillestar në Bogë të Rugovës, në Prevallë dhe në Brod të Dragashit. (Zekë Çeku)

TURIZMI SHËNDETËSOR. Veprimtari turistike që ka për qëllim të motivojë turistët ose vizitorët të udhëtojnë dhe qëndrojnë në vende të ndryshme për qëllime shërimi, të trajtimit shëndetësor, ose në mënyrë proaktive të përmirësojnë dhe ruajnë shëndetin mental dhe fizik. Kjo mund të arrihet në destinacionet adekuate, në banjat me burime termale, në bregdet dhe në vende klimatike. Turizmi shëndetësor në Kosovë, përgjithësisht me qëllim të trajtimit kurativ të sëmurëve, zhvillohet në Banjën e Pejës dhe në Banjën e Kllokotit, afër Vitisë. Përgjatë dekadës së fundit ndërtohen kapacitete të reja në Kllokot, ku afër qendrës së vjetër është ndërtuar qendra "Nëna Naile" me një kapacitet prej më së 1,600 shtretër. Pas privatizimit të banjës së vjetër të Kllokotit, kjo qendër disponon 680 shtretër. Që nga viti i kaluar 2014, gjithashtu pas privatizimit, është rindërtuar qendra e parë e Banjës së Pejës (Istogut), me një kapacitet fillestar prej 280 shtretër, si dhe është përgatitur plani zhvillimor për rehabilitimin dhe ngritjen e nivelit të Hotelit "Oniks" në afërsi. Në vitin 2015 në Kosovë operonin tri qendra banjeare me ujëra termale me gjithsej 2,560 shtretër. (Zekë Çeku)

TURIZMI. Një shumësi aktivitetesh, e shërbimeve dhe e industrive, të cilat ofrojnë eksperiencë të udhëtimeve, përfshirë transportin, akomodimin, strukturat që ofrojnë ushqim dhe pije, dyqane me shitje me pakicë, bizneset e zbavitjes si dhe shërbimet e mikpritjes të ofruara për vizitorët individualë dhe të grupeve të organizuara, të cilët udhëtojnë jashtë vendba-

nimit të tyre. Turizmi është një aktivitet biznesor i fokusuar në sektorin e shërbimeve, për t'u ofruar konsumatorëve paketa atraktive dhe të përshtatshme të pushimeve brenda ose jashtë vendit. Zhvillimi më i fuqishëm i turizmit dhe i industrisë turistike në rajon, në Europë dhe në nivel global lidhet me zhvillimin e hovshëm të industrisë së komunikacionit ajror dhe zhvillimin e hovshëm ekonomik. Në vitet e pas Luftës së Dytë Botërore dhe deri në mesin e viteve '70 të shekullit XX, në ish-Jugosllavi, shërbimet turistike ofroheshin kryesisht në shtatë qendrat kryesore urbane, në Prishtinë, në Pejë, Prizren, Mitrovicë, Gjilan, Ferizaj dhe në Gjakovë, kurse në fund të viteve '70 edhe në Qendrën e Skijimit në Brezovicë. Në vitet që pasuan u ndërtuan hotele moderne në Prishtinë, në Prizren, në Gjakovë dhe në Brezovicë. Por, përveç këtyre strukturave, në vitet '80 dhe prapa turizmi kosovar filloi të degradojë dhe të humbë pozicionimin që kishte fituar më parë. Në këtë kohë realizohen investime të rëndësishme edhe në dy banjat e Kosovës, në Banjën e Pejës dhe në Banjën e Kllokotit, por nuk arrihet të investohet në strukturat turistike në rajonet më atraktive, në rajonet më potenciale, më cilësore, siç janë rajonet e Bjeshkëve të Nemuna, të Sharrit, të Shalës së Bajgorës dhe të Anamoravës. Zhvillimi i turizmi kosovar pas luftës së fundit karakterizohet me dy procese të njëkohshme, siç është privatizimi i kompanive hoteliere dhe turistike, si dhe zhvillimi i strukturave turistike dhe të mikpritjes në sektorin privat. Në fillim të shekullit XXI, në dekadën e parë, ndërtimet e strukturave turistike bëhen pa ndonjë plan dhe pa orientime të mirëfillta profesionale, duke ndërtuar objekte kryesisht të standardeve mesatare dhe më të ulëta jashtë qendrave të atraksionit primar dhe sekondar. Duke u bazuar në resurset e pasura turistike në tërë Kosovën, si dhe të vlerave dhe të diversitetit të theksuar natyror dhe kulturor, Kosova potencialisht mund të orientohet në zhvillimin e formave të turizmit kulturor dhe urban, pastaj të turizmit të bazuar tek aktivitetet në natyrë (turizmi malor, veror, dimëror etj.), turizmi shëndetësor dhe i banjave, si dhe turizmi i komuniteteve (rural, agroturizmi, ekoturizmi, turizmi i traditës etj.). (Zekë Çeku)

TURJAKA Bujar (1968-). Profesor universitar, skiator. Lindi në Pejë. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, studimet në

Fakultetin e Kulturës Fizike në Universitetin e Prishtinës. Po në këtë fakultet mbaroi studimet pasuniversitare dhe mbrojti temën e doktoratës (2004). Që herët filloi të merrej me skitari alpine në Klubin “Rusolia” nga Peja. Disa herë u zgjodh skiatori më i mirë i vitit dhe në mesin e 10 sportistëve më të mirë të Kosovës. Në periudhën 1995-2012 ushtroi detyrën e kryetarit të klubit skitar “Rusolia” dhe kreu detyra me përgjegjësi në Federatën e Skitarisë së Kosovës. Është i pajisur me licencë ndërkombëtare të trajnerit të skitarisë (SIAS) në vitin 2009. Ndërkohë nis punë në Fakultetin e Kulturës Fizike, ku ligjëron lëndët ski dhe aktivitetet në natyrë. Në vitet në vijim avancohet në të gjithë titujt universitarë, përfshirë edhe titullin profesor i rregullt (2012) për lëndët skijim dhe rekreacion sportiv. (Rifat Gjonbalaj)

TURKU Ahmet (1957-). Futbollist. Lindi në Pejë. Angazhimet e para në futboll i filloi në KF “Buduqnost” të Pejës. Ishte pjesë e “Buduqnostit” në ligën e dytë të ish-Jugosllavisë, ndërsa në vitet 1980-1981 kaloi në KF “Trepça”. A. Turkun e gjejmë të angazhuar në klubin e “Trepçës” deri në mbarimin e karrierës profesionale në vitin 1988. Luajti kryesisht në repartin mbrojtës (qendërmbrojtës). Pas luftës vazhdon angazhimet si vëzhgues i Federatës së Futbollit të Kosovës. (Rifat Gjonbalaj)

TURKU Halil (1935-). Matematikan, profesor universiteti. Lindi në Pejë, ku kreu shkollën fillore dhe të mesme. U diplomua në degën e matematikës të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Sarajevës (1960). Zgjidhet asistenti i parë në degën e matematikës të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës (UP), më pastaj ligjërues dhe profesor ordinar (1982). Kreu studimet pasuniversitare në Fakultetin e Shkencave



HALIL TURKU

Matematike-Natyrore (FSHMN) të Universitetit të Beogradit (1974), ndërsa tezën e disertacionit e mbrojti në FSHMN të UP-së (1976). Mbahti disa kurse për studentët e studimeve pasuniversitare në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Nishit dhe udhëhoqi disa kandidatë në studimet master dhe të

doktoratës. Për qëllime studimore qëndroi në disa universitete europiane. Publikoi punime shkencore në revista ndërkombëtare dhe vendore, tekste për shkolla të mesme dhe tekste universitare (“Teoria e funksioneve të variablilit kompleks”, “Përmbledhje detyrash nga teoria e funksioneve të variablilit kompleks” etj.). Mori pjesë me kumtesa në shumë tubime shkencore brenda dhe jashtë vendit. Ka qenë njëri nga themeluesit e departamentit të matematikës të FSHMN-së të Universitetit të Prishtinës dhe ka kryer detyra me rëndësi në institucionet e arimit të lartë të Kosovës. (Minir Efendija)

TURQIZMAT. Fjalë, shprehje, thënie apo kompozim i gjuhës turke, që ka hyrë në disa gjuhë të Ballkanit, fillimisht nëpërmjet kontaktit të ushtrisë turke me popujt e kësaj treve dhe më vonë si rezultat i ndikimit të administratës turke të vendosur në këto territore. Turqizmat në gjuhën shqipe hasen në të gjitha fushat e jetës e të veprimtarive të ndryshme shoqërore: në jetën shtëpiake (*tepsi, oxhak, konak, jorgan*); në jetën shoqërore (*beqar, çoban, mysafir, ortak*); në sistemin ushtarak, shtetëror e administrativ (*top, bajrak, sanxhak, pasha, topuz*). Me turqizmat e shqipes janë marrë H. Kaleshi, N. Borecki, T. Dizdari, A. Krajni, E. Çabej, M. Polisi etj. (Jahja Hundozi)

TYGJECL. Fshat në komunën e Kamenicës, rreth 15 km në veri të qendrës komunale. Është vendbanim malor, në lartësi mbidetare 900 m, në kufi më komunën e Medvegjës. Fshati është përfshirë nga valët intensive të shpopullimit. Në vitin 1948 kishte 966 banorë, kurse tani ka 130 banorë (2011). Veprimtaritë kryesore ekonomike janë blegtoria dhe pylltaria. Është bashkësi lokale, ku gravitojnë disa vendbanime: Sfircë, Zajçec, Gmicë dhe Gjyrishec. (Muhamed Kallaba)

TYRBJA E SULLTAN MURATIT. Është monument mbivarror, sipas legjendës, i ngritur në vendin ku u vra sulltan Murati, në Betejën e Kosovës të vitit 1389. E ngritur në fshatin Mazgit afër Obiliqit, tyrbja nuk e ka ruajtur gjendjen fillestare, sepse ka pësuar disa rinovime. Për rinovimin e parë dëshmon Evlia Çelebiu, që në vitin 1660. Rinovimi i dytë u bë në vitin 1845, ndërsa ai vijues u bë në vitin 1907. Pas luftërave ballkanike (1912), mirëmbajtja e tyrbes u përfshi në traktatin e paqes ndërmjet Turqisë



TYRBJA E SULLTAN MURATIT NË MAZGIT

dhe Serbisë (1914), ndërsa në vitin 1960 tyrbja mori atributin e monumentit të mbrojtur nga shteti. Rinovimi i fundit i Tyrbes së sulltan Muratit u bë në vitin 1989 nga ish-Jugosllavia, me rastin e 600-vjetorit të Betejës së Kosovës. Tyrbja ka planimetri të katërkëndëshit kënd-

drejtë, është njëhapësinore dhe me hajat që mbulohet me kube. Pos derës hyrëse, që mbulohet me hark, dritaret e mureve konstruktive janë të mbuluara me arkitra. Tyrbja e Muratit, pos profilizimeve të hapjeve, ka edhe dekorime plastike. Plastika gurore, e realizuar në teknikën e relievit të imët, i takon stilit të barokut osman të përhapur edhe në artin kosovar. Në kuadër të tyrbes janë edhe disa varreza me nishane dhe kaliografi, kryesisht të personave që janë kujdesur për tyrben.

Tyrbet si objekte kulti janë ndërtuar në shumë qytete e fshatra të Kosovës. Diku-diku gjenden të veçuara, por edhe si pjesë përbërëse të xhamive, të teqeve ose të varrezave. Përveç Tyrbes së sulltan Muratit, tyrbe të njohura në Kosovë janë edhe Tyrbja e Bajraktarit në Mazgit, afër Prishtinës, Tyrbja e Gazi Mehmet pashës në Prizren, Tyrbja e Novobërdës si dhe rrënojat e Tyrbës në Xhaminë e Defterdarit në Pejë. (Orges Drançolli)

TH

THAÇI Abaz (1964-1999). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Hero i Kosovës. Lindi në fshatin Vojnik të komunës së Skënderajt. Studioi në Akademinë Ushtarake në Zagreb, ku u diplomua si oficer i logjistikës. Shërbeu në ushtrinë jugosllave katër vjet. Pas fillimit të luftës në Kroaci më 1990 dezertoi nga ushtria dhe emigroi në Gjermani. Më 1998 u kthye në Kosovë. U emërua në njësinë e Gardës ushtarake të Kosovës “Skënderbeu”. Në prill të vitit 1999 u vendos në Padesh, në vijën e kufirit Kosovë-Shqipëri. Më pas u emërua komandant i njëres prej zonave të luftimeve në Koshare, detyrë që e kreu deri në rënie. Më 26 prill 1999, A. Thaçi, me dy ushtarët e tij, kapi të gjallë korrierin e komandantit serb, të cilin ia dorëzuan forcave të NATO-s. Më 16 maj 1999, në ditën kur u zhvillua njëra nga betejat më të mëdha në frontin e Koshares, ra te vendi i quajtur Rrasa e Koshares. Presidentja e Kosovës në shkurt të vitit 2016 e dekoroi me Urdhrin “Hero i Kosovës”. (Mustafë Haziri)

THAÇI Abdullah (1942-2015). Shkrimtar. Lindi në Novosellë të Pejës, ku kreu shkollën fillore. Mbaroi shkollimin e mesëm në Pejë, kurse Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore, drejtimin e kimisë, në Prishtinë. Punoi si mësimdhënës në gjimnazin e Prizrenit dhe zyrtar në drejtorinë e arsimit të kësaj komune. Në letërsinë për fëmijë njihet si poet, që shquhet si me botën e tij tematike, ashtu edhe me mënyrën e sendërtimit artistik të saj. Poezitë e tij janë tërheqëse për lexuesit e vegjël, sa për shkak të temave të afërta me jetën e përditshme në shkollë e në familje, aq për vargun e skalitur me kujdes e ndjeshmëri të veçantë, për figuracionin e pasur dhe humorin e lehtë që i përshkon ato. Është po ashtu ndër kultivuesit e rrallë të gjëgjëzës. Kritika letrare e

vlerësoi krijimtarinë e tij. Është laureat i çmimit të revistës “Pionieri” për librin më të mirë të vitit, i çmimit “Sofra poetike” dhe i çmimit “Ymer Elshani”. Veprat e botuara: “Lumi i dritës” (1980), “Duke pritur ylberin” (1983), “Piknik poetik” (1986), “Ani Kosovë, ani” (1994), “Mes dy dashurish” (1997), “Vjersha hutaqe” (2004), “Përralla nga Prevala” (2008) etj. (Arif Demolli)

THAÇI Adelina (1980-). Këngëtare. Lindi në Prishtinë, ku kreu edhe Shkollën e Mesme të Muzikës (1995). Studimet i vazhdoi në Fakultetin e Arteve, dega e muzikës, po ashtu në Prishtinë. Që nga shkolla e mesme e filloi karrierën muzikore dhe u bë e njohur si këngëtare e muzikës së lehtë. Ka një repertor të gjerë këngësh, me të cilat është paraqitur në festivale e manifestime të ndryshme muzikore, ku mori dhe disa çmime, si: çmimi i parë në një nga festivalet e Radiotelevizionit Shqiptar, si debutantja më e mirë, vendin e dytë në Festivalin “Kosovarja këndon” etj. Ishte dhe anëtare e Korit të Filarmonisë së Kosovës dhe mësimdhënëse e muzikës. (Kristina Palokaj-Perkola)

THAÇI Edmond (1980-). Gazetar i sportit. Lindi në Prishtinë. Studioi për gazetari dhe art. Me gazetari filloi të merret edhe para studimeve, me shkrime në javoren “Zëri” dhe pastaj në revistën sportive “Top sporti”. Pas luftës, një kohë të shkurtër punoi edhe në portalin “Kosovalive”, kurse që nga vitit 2006 punon në Radiotelevizionin e Kosovës. (Moral Pozhegu)

THAÇI Hashim (1968-). Njëri nga themeluesit kryesor të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), kryetar i Partisë Demokratike të Kosovës, kryeministër, ministër i Jashtëm dhe



HASHIM THAÇI

president i Republikës së Kosovës. Lindi në fshatin Burojë të komunës së Skënderajt. Që herët u përfshi në lëvizjet politike të kohës. Në vitin 1988 u regjistrua në degën e historisë të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Ishte pjesëmarrës aktiv në grevat dhe demonstratat studentore gjatë viteve 1989-1990. Në vitin 1991 u zgjodh prorektor-student i Universitetit të Prishtinës. Pas largimit të dhunshëm të studentëve dhe mësimdhënësve nga objektet universitare, punoi për ngritjen dhe strukturimin e arsimit universitar në objekte dhe shtëpi private. Në vitin 1993 përfundoi studimet për histori në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Në fund të viteve '80 u përfshi në organizimin politik të Lëvizjes Popullore për Republikën e Kosovës. Në vitin 1993 policia serbe dështoi në përpjekjet e saj për ta burgosur. Emigroi në Zvicër, ku më pas në Universitetin e Cyrihut ndoqi studimet pasuniversitare për histori dhe shkencë politike. Gjatë viteve '90 u kthye disa herë ilegalisht në Kosovë dhe mori pjesë në organizimin politik dhe ushtarak të UÇK-së. Në kuadër të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së u zgjodh drejtor i Drejtorisë Politike. Nga 6-22 shkurt 1999 kryesoi delegacionin e UÇK-së si dhe delegacionin e Kosovës në Konferencën Ndërkombëtare në Rambuje (Francë). Konferenca përfundoi në Paris më 18 mars 1999, ku pas nënshkrimit të palës shqiptare dhe refuzimit të palës serbe, iu hap rruga intervenimit ushtarak të NATO-s. Nga marsi i vitit 1999, me marrëveshjen e faktorit politik të Kosovës, H. Thaçi u emërua kryeministër i Qeverisë së Përkohshme të Kosovës (Qeveria e Unitetit). Pas luftës, në rolin e kryeministrit dhe të liderit të UÇK-së udhëhoqi negociatat me faktorin ndërkombëtar për demilitarizimin e UÇK-së dhe transformimin e saj në Trupat Mbrojtëse të Kosovës (TMK). Nga janari i vitit 2000, pas shpërbërjes së Qeverisë së Përkohshme dhe deri në zgjedhjet e para parlamentare (2001), H. Thaçi ishte anëtar i Këshillit të Përkohshëm Administrativ (KPA), i cili si strukturë e përbashkët me misionin e OKB-së në Kosovë (UNMIK), qeverisi vendin në këtë fazë transitore. Ndërkohë, në vitin

2000, në kuvendin e parë zgjedhor të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) H. Thaçi u zgjodh dhe u rizgjodh kryetar i kësaj partie deri më 26 shkurt 2016. Në pesë legjislaturat e Kuvendit të Kosovës u zgjodh deputet. Është lider politik me numër më të madh të votave në zgjedhjet e fundit parlamentare në Kosovë. Gjatë procesit negociator (2005-2007) për statusin përfundimtar të Kosovës, të udhëhequr nga i dërguari i posaçëm i OKB-së, presidenti Martti Ahtisaari, H. Thaçi ishte anëtar i Ekipit të Unitetit. Dokumenti i Ahtisaarit rezultoi me propozimin gjithëpërfshirës për Pavarësinë e Kosovës. Pas fitores së Partisë Demokratike të Kosovës në zgjedhjet parlamentare të 17 nëntorit 2007, H. Thaçi u zgjodh kryeministër. Më 17 shkurt 2008, si kryeministër i Republikës së Kosovës, në Kuvendin e Kosovës shpalli Kosovën shtet të pavarur, sovran dhe demokratik. Pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 2010 dhe formimit të qeverisë "Thaçi 2", pas disa rundeve të bisedimeve me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian, nënshkruan marrëveshjen ndërmjet shtetit të Kosovës dhe atij të Serbisë për normalizimin e marrëdhënieve midis dy vendeve (Bruksel, 19 prill 2013). Pas arritjes së kësaj marrëveshjeje, me iniciativën e disa kongresmenëve amerikanë dhe deputetëve të Parlamentit Evropian, Hashim Thaçi është propozuar për çmimin Nobel për Paqe (2013). Pas zgjedhjeve të qershorit të vitit 2014, në qeverinë e koalicionit PDK-LDK (Lidhja Demokratike e Kosovës), H. Thaçi mori postin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Jashtëm të Kosovës, post që e mbajti deri në mars të vitit 2016. Më 26 shkurt 2016 nga Kuvendi i Kosovës u zgjodh president i Republikës së Kosovës, detyrë që e mori më 7 prill 2016, pas betimit solemn në Kuvendin e Kosovës. Është bartës i shumë mirënjohjeve dhe dekoratave. (Ismail Sylja)

THAÇI Menduh (1965-). Politikan. Lindi në Tetovë, ku kreu shkollimin fillor dhe të mesëm, kurse diplomoi në Fakultetin e Mjekësisë, dega e stomatologjisë, në Universitetin e Prishtinës. Në vitet '90 ishte aktiv në degën e Tetovës të Partisë për Prosperitet Demokratik (PPD). Ishte nënkryetar i Partisë për Prosperitet Demokratik të Shqiptarëve (PPDSH), ndërsa në Kongresin e Bashkimit mes Partisë për Prosperitet Demokratik Shqiptar (PPDSH) dhe Partisë Demokratike Popullore (PDP), 5-7



MENDUH THAÇI

ishte deputet në Parlamentin e Maqedonisë disa mandate. Si kryetar i PDSH-së hyri në koalicionin me VMRO-DPMNE-në e Nikolla Gruevskit në vitet 2006-2008. Së fundi dha dorëheqje nga kryetari i PDSH-së, pas humbjes në zgjedhjet e 11 dhjetorit 2016. (Arsim Sinani)

THAÇI SH. Ali (1938-2006). Mjek, internist, kardiolog. Lindi në Gjakovë, shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në vendlindjen, studimet në Fakultetin e Mjekësisë në Sarajevë (1964). Pas diplomimit u emërua mjek në Shtëpinë e Shëndetit në Gjakovë. Kreu specializimin për mjekësi interne në Zagreb. Në vitin 1972 u zgjodh asistent i lëndës mjekësia interne në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës. Vijoi studimet pasuniversitare dhe bëri subspecializimin për kardiologji po në Zagreb, ku mbrojti temën e doktoratës. Në periudhën 1982-1999 punoi në Poliklinikën e kombinatit “Emin Duraku” në Gjakovë. Ishte pjesëmarrës në shumë kongrese e simpoziume dhe publikoi një sërë punimesh shkencore si autor dhe bashkautor. Botoi edhe disa doracakë, ndër të cilët edhe doracakun “Ekokardiografia si metodë diagnostike në kardiologji”, tekstin universitar për ekokardiografinë, monografinë “Bllloqet degëzore të zemrës” etj. (Ahmet Brovina)

THERANDA. Shih: **SUHAREKA.**

THERANDA. Vendbanim i periudhës romake. Sipas Tabula Peutingeriana gjendej në radhë me stacionet e tjera përgjatë via Lissus-Naissus: “...Ad Fines XX - Vindenis XX - Viciano XXV - Theranda XXV - Gabuleo...” Ndeshet me emrin Theranda dhe Thermidave në disa burime antike, si te Ptolemeu, Anonimi i Ravenës dhe Tabula Peutingeriana. Ubifikimi i qytetit vazhdon të jetë temë diskutimi dhe mendohet se gjendej në arealin midis Prizrenit dhe Suharekës, te hapësira me toponim “Torazhda”,

korrik 1997, u zgjodh njëri nga nënkryetarët e kësaj partie. Më vonë ishte nënkryetar i Partisë Demokratike Shqiptare (PDSH), në periudhën kur këtë parti e drejtonte Arbën Xhaferi, ndërsa pas dorëheqjes së tij, u bë kryetar i saj. M. Thaçi

ndërmet fshatrave Tërrnje dhe Leshan, apo te “Taranda” te Gjilanci i Suharekës. (Arben Hajdari)

THESARI I ÇELLOPEKUT. Thesar i madh i drahmeve të Apolonisë, i zbuluar në “Tamnik” të Çellopekut, 15 km në juglindje të Pejës. Një pjesë e tij është blerë nga Muzeu Popullor i Beogradit në vitin 1961. Përbëhet nga 475 drahme të Apolonisë dhe dy imitacione barbare. Datimi i përafërt i këtij thesari lidhet me kohën e luftës së dardanëve kundër Skribion Kurionit (75-72) dhe rënies së Dardanisë nën sundimin romak. Thesari i Çellopekut është gjetje e veçantë, pasi përmban vetëm monedha të Apolonisë dhe jo edhe të Dyrhacionit, siç gjenden zakonisht. (Fatmir Peja)

THESARI I DOBRATINIT. Koleksion i groposur i monedhave, i zbuluar rastësisht gjatë punimeve bujqësore në Dobratin (Lipjan), në rrënojat e një kompleksi arkitektonik (1961). Thesari përmban rreth 6,000 monedha dhe dy llamba bronzi. Në të kishte prerje të imëta (centionalis) të periudhës së sundimit të perandorit Konstantin dhe të anëtarëve të familjes së tij. Pjesa më e madhe e monedhave i përket emisioneve të prera gjatë viteve 337-345. Këto vijnë nga vendfarkimet e njohura të kohës, siç ishin Thesalonici, Siscia, Nicomidia, Antiochia, Constantinopolis, Kyzcos, Alexandria, Heracleae, Roma, Aquilea, Lugdunum etj. (Fatmir Peja)

THESARI ISHTETIT. Departamenti i Thesarit u themelua me një rregullore të UNMIK-ut të vitin 1999, në kuadër të Autoritetit Qendror Fiskal. Pas formimit të Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave, ky departament ka kaluar në kuadër të kësaj ministrie. Përgjegjësitë kryesore të departamentit të Thesarit janë paraqitur në Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë. Këto përgjegjësi përfshijnë: menaxhimin e fondit të konsoliduar të Kosovës, menaxhimin e llogarive bankare, menaxhimin e shpenzimit të fondeve, vendosjen e proceseve të mbledhjes së parave publike, themelimin dhe mirëmbajtjen e regjistrave kontabël, përgatitjen e pasqyrave financiare dhe mirëmbajtjen e rregullave financiare (Bedri Hamza)

THUNATËT. Një ndër fiset kryesore i vendosur në pjesën lindore të Dardanisë. Autori

antik Straboni i rendit si fisin e tretë më të rëndësishëm dardan. Të bashkuar me dardanët, galabrët e daunët krijuan territor kompakt, i cili u quajt Dardania. Gjatë shek. IV p.e.r.-I ishin pjesë të shtetit të Dardanisë, i cili dominoi Ballkanin Qendror, e rrezikoi shtetin e Maqedonisë në vazhdimësi dhe i rezistoi rreth dy

shekuj pushtimeve romake. Në lindje të thunatëve banonin medët, fis thrak, me të cilët Dardania kishte fqinjësi të mirë dhe bashkëpunim të gjatë. Një pjesë e tyre migroi në Italinë Jugore (kapërcyelli i mijëvjeçarëve II-I p.e.r.), bashkë me galabrët dhe daunët, fise dardane. (Emine Kalaja-Hajdari)

U

UILSON Udoro (Woodrow Wilson) (1856-1924). Politikan dhe burrshtetas i SHBA-së, njëri prej udhëheqësve të Partisë Demokratike. Ishte president i SHBA-së gjatë viteve 1913-



UDRO UILSON

1921. Vilson më 1913 formuloi doktrinën e tij mbi rendin ndërkombëtar, bazë e të cilit ishin të drejtat universale dhe jo ekuilibri i forcave. Në vitin 1917 e përfshiu SHBA-në në Luftën e Parë Botërore. Në vitin 1918 paraqiti 14 pikat e njohura, në të cilat bëhet fjalë për parimet e vendosjes së paqes botërore. Pas Luftës së Parë Botërore mori pjesë në Konferencën e Paqes në Versajë dhe më vonë hodhi idenë për krijimin e Lidhjes së Kombeve (1919). Senati Amerikan refuzoi paqen e Versajës dhe përfshirjen e SHBA-së në Lidhjen e Kombeve. Presidenti Wilson hodhi poshtë kompromisin e janarit të vitit 1920 për ndarjen e Shqipërisë, të arritur në mes të kryeministrit anglez, francez dhe atij italian. Si rezultat i kundërshtimit të presidentit Wilson, përfaqësuesit anglezë dhe francezë më 26 shkurt 1920 njoftuan se hiqnin dorë nga kjo nismë. Vilson mori Çmimin Nobel për paqe në vitin 1919. (Iilir Zylfiu)

UJËNDARËSI DETAR. Kurriz natyror, i cili ndan ujërat e reshjeve në drejtim të deteve të ndryshme. Zakonisht ujëNDARËSI ndjek kuotat më të larta të relievit dhe mund të jetë topografik, që ndan ujërat sipërfaqësore dhe hidrogeologjik, që ndan ujërat nëntokësore. Në terrenet e ndërtuara nga shkëmbinj të tretshëm karbonatikë (gëlqerorë, dolomitë etj.), ujëNDARËSI topografik nuk përputhet me atë hidrogeologjik (Bjeshkët e Nemuna).

Për shkak të pozitës gjeografike, të ndërtimit gjeologjik-tektonik, të veçorive morfologjike, ujërat e Kosovës përbëjnë një hidrografike të Gadishullit Ballkanik, që është Suka e Dërmanit (1,364 m), e cila ndodhet ndërmjet maleve të Jezercit dhe Nerodimes (12 km në lindje të Suharekës). Përbëhet nga rreshpe të paleozoikut. Suka e Dërmanit paraqet kyç tredrejtimësh, nga i cili ujërat rrjedhin në drejtim të Detit të Zi, Adriatikut dhe Egjeut. Nga e njëjta pikë (kodër) buron lumi i Buzhalës (që shkon në drejtim të detit Adriatik), lumi i Devetakut (Detit të Zi) dhe lumi i Dërmanit (detit Egje). Është dukuri e rrallë hidrografike, e vetmja në Gadishullit Ballkanik. (Valbon Bytyçi)


UJËRAT NËNTOKËSORE. Paraqesin ujërat që gjenden në sipërfaqen e Tokës, përkatësisht në litosferë, pavarësisht nga prejardhja, vetitë fizike e kimike, përbërja radiologjike e mikrobiologjike, në gjendje të lëngët, të gaztë ose të ngurtë, të cilët mbushin poret dhe të çarat e shkëmbinjve. Në thellësi të vogla ose afër sipërfaqes së tokës zakonisht paraqitet horizonti (akuiferi) i ujërave freatike (të lira, pa trysni), i kaptuar në ambientin gjeologjik ujëmbajtës, i cili është i vendosur mbi ambientin gjeologjik (shkëmbinj të) joutjëlëshues. Formohen në sedimentet ujëmbajtëse, të cilat janë të kufizuara poshtë e lart me shtresa joutjëlëshuese (argjila etj.). Ujërat nëntokësore në një shkallë të ulët ose të lartë janë të mineralizuara me kripëra ose gazra. Pjesa e ujërave nëntokësore me mineralizim nën 1.0 g/l dhe pa rritje të mikrokomponenteve, gazrave etj., janë ujëra që përdoren për pije dhe në industrinë ushqimore. Ujërat e mineralizuara kanë vlera të rritura të mineralizimit (mbi 1.0 l/g), të gazrave, mikroelementeve, radioaktivitetit ose

temperaturës (ujërat termominerale) dhe përdoren për mjekim, për përfitimin e lëndëve të para industriale (kripërave), për ngrohje ose edhe për përfitimin e energjisë elektrike. Kosova nuk karakterizohet me rezerva të mëdha të ujërave nëntokësore. Ato gjenden kryesisht në shkëmbinj gëlqerorë të karstifikuar, që kanë përhapje të madhe në Bjeshkët e Nemuna, në Malet e Sharrit, malin e Milanovcit etj. dhe përcillen me burime (gurra) të fuqishme. Gurra e Radavcit, me prurje mesatare 5.0 m³/sek, shënon fillimin e Drinit të Bardhë. Gurrat tjera janë: e Vrellës së Istogut, e Vërmicës, e Studençanit, e Korishës etj. Rezerva më të vogla të ujërave nëntokësore ka edhe në akuiferët intergranularë, në depozitimet (sedimentet) e pliocen-kuaternarit në fushëgropat e Dukagjinit dhe të Kosovës, të cilat shpeshherë paraqiten me trysni (ujëra arteziane) në rajonin e Istogut, Prizren-Suharekës etj. Kosova shquhet edhe për rezerva të konsiderueshme të ujërave nëntokësore minerale dhe termominerale. Janë të njohura mbi 30 burime minerale, termale e termominerale të përqendruara kryesisht në pjesën lindore të Kosovës, ndërsa më pak në Dukagjin. Ndër më të njohurit janë: burimet e Banjskës, Banja e Pejës, Banja e Kllokotit, Banja e Malishevës, Burimet e Uglarit, Burimi i Kmetovcit, Burimi i Lluzhanit, Burimi i Sllatinës, Uji i Thartë i Deçanit, i Poklekut etj. (Vahdet Pruthi)

UJËRAT TERMOMINERALE. Ujëra nëntokësore me mineralizim mbi 1.0 g/l, ose edhe me temperaturë mbi 20°C, të cilët në të shumtën e rasteve, krahas makroelementeve kimike, përmbajnë edhe sasi të rritura të komponenteve specifike me veprim farmakologjik në organizmin e njeriut (CO₂, H₂S, Rn, Fe, Br, J etj.). Shfrytëzohen për balneologji, për përfitimin e përbërësve të ndryshëm kimikë dhe gazeve në rrugë industriale. Për nga përbërja kimike ujërat termominerale ndahen në disa lloje: karbonate (Ca, Na, Mg), klorure, sulfure etj. Në Kosovë janë evidentuar mbi 34 burime të ujërave termominerale. Për nga përbërja kimike kryesisht janë ujëra hidrokarbonat të natriumit, kalcium-magnezit, natrium-kalciumit ose magnez-natriumit. Kryesisht përmbajnë dioksid të karbonit dhe në shumë raste edhe oksid hekuri, fluor, oksid të aluminit, acid metabolik, dioksid të silicit, stroncium, man-

gan, radon etj. Ujërat minerale më të njohura janë: i Deçanit (mineralizimi: 1,433 g/l; prurja: 2.0 lit/sek), i Poklekut (3,903 g/l; prurja 1.0 l/sek), Uji i Thartë (3.93 g/l; prurja 0.6 l/sek), Ponesh etj. Ujërat termale të njohura janë: Banja e Thartë (27°C), Banja Vuça (30°C), Burimi i Nxehtë i Banjës (23°C), Banja e Malishevës (26°C), e Uglarit (26°C) etj. Ndërsa nga ujërat termominerale të njohura janë: Banja e Kllokotit, Banja e Pejës dhe Banjska, që shfrytëzohen për balneologji dhe për përdorime të tjera në perspektivë. (Vahdet Pruthi)

UJËVARAT E MIRUSHËS. Ujëvara të krijuara nga lumi Mirusha, në gëlqerorët e kretakut të sipërm, në rrjedhjen e poshtme të lumit Mirusha, në gjatësi rreth 2 km. Janë 12 ujëvara



PAMJE E UJËVARËS SË MIRUSHËS

me 16 liqene me dimensione të ndryshme. Lumi i Mirushës në këtë pjesë ka krijuar edhe kanionin me të njëjtin emër, i kushtëzuar nga tektonika shkëputëse dhe veprimtaria erozive lumore, në të cilin janë të lokalizuara ujëvarat dhe liqenet. Gjerësia më e madhe e kanionit është në liqenin e fundit, ndërsa pjesa më e ngushtë në liqenin e katërt. Në këtë sektor thellësia e kanionit arrin 200 m, me shpatë të thikta, gati vertikale. Ujëvarat dhe kanioni i Mirushës janë shpallur park rajonal (1982) me sipërfaqe prej 555 ha, ndërsa më vonë (2012) janë shpallur monument i natyrës me rëndësi të veçantë në një sipërfaqe prej 598.4 ha. (Fadil Bajraktari)

UJKANI Qerim (1937-2015). Poet, përkthyes. Lindi në Pejë. Kreu shkollimin fillor dhe të mesëm në vendlindje, ndërsa në Beograd studioi shkencat juridike. Për shumë vjet ishte gazetar dhe redaktor i emisioneve letrare në



QERIM UJKANI

Radio Prishtinë, duke dhënë kontribut të veçantë në afirmimin dhe promovimin e veprave letrare, të cilat botoheshin në Kosovë. Ka bërë shkrime letrare në gjini të ndryshme, por përqendrimin kryesor krijues në krijimtarinë e tij e zë poezia. Ndër veprat e tij të botuara janë: “Hu-llinat” (1963), “Deti ose poema e shqetësuar” (1968), “Antisonete” (1972), “Hije e këputur” (1982), “Kthimi i ushtarit në shtëpi” (1997), “Elegji mëngësore” (2009), “Qyteti i zi” (2011) etj. Poezia e Q. Ujkanit trajton fenomenet më të ndieshme të identitetit shqiptar, duke filluar nga ekzistenca për të mbërritur deri të krenaria kombëtare. Poezia e tij shquhet për figuracionin e pasur dhe gjetjet interesante poetike. Ka përkthyer vepra të ndryshme nga gjuha shqipe në gjuhën serbokroate dhe është prezantuar në antologji të ndryshme dhe në panoramën e poezisë bashkëkohore shqiptare në gjuhën shqipe, serbokroate dhe në disa gjuhë të tjera. (Sali Bashota)

UJKANI Samir (1998-). Futbollist. Lindi në fshatin Resnik të Vushtrrisë. Si gjashtëvjeçar së bashku me familjen migroi në Belgjikë. Në moshën 13-vjeçare iu bashkua skuadrës “KSV Ingelmunster” (2001-2007), para se të kalonte te “Anderlehti”. Kaloi te skuadra italiane “Palermo” më 2008. Më 2009 u huazua te “Novara”, që bënte gara në kategorinë e tretë. Në edicionin e parë ndihmoi “Novaran” të kthehet në Serinë B pas 33 vjetësh, kurse me të njëjtën skuadër luajti një edicion edhe në Seria A. Në fillim të edicionit 2014/15 u kthye sërish te “Palermo”. Në tetor të vitit 2008 mori ftesë nga kombëtarja A e Shqipërisë për ndeshjet mënjuese të Kampionatit Botëror “Afrika e Jugut 2010”. Pas 20 paraqitjeve te Shqipëria, në fillim të vitit 2014 vendosi të jetë pjesë e përfaqësueses së Kosovës. Luajti në ndeshjen me Haitin, që ishte e para për Kosovën, pas lejes nga FIFA. (Arsim Maxhera)

UJMIRI. Fshat në komunën e Klinës, 12 km në lindje të saj. Shtrihet në lartësi mesatare mbidetare 500 m. Është vendbanim i tipit të shpërndarë me lagjet e Millakëve, Racëve, dhe Shaljanëve. Përmendet si vendbanim

në disa dokumente mesjetare. Në vitin 2011 kishte 544 banorë, ndaj 201 banorëve në vitin 1948. Sipërfaqja e territorit të fshatit është 318 ha, nga e cila pjesën dërrmuese (70%) e zënë arat. Popullsia merret me bujqësi dhe blegtori, tregti etj. Nga objektet e standardit shoqëror ka shkollën 9-vjeçare, stacionin shëndetësor dhe disa njësi tregtare. Është bashkësi lokale në të cilën gravitojnë vendbanimet: Ujmir, Çabiq, Siqevë dhe Dobërdol. (Ferim Gashi)

UKA Lec (1954-1998). Mjek, specialist i mjekësisë së përgjithshme, dëshmor. Lindi në Dodonë (Gradicë) të Drenicës. Shkollimin bazë e kreu në vendlindje dhe Prishtinë. Studioi në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë dhe specializoi për mjekësi të përgjithshme, gjithashtu në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. Punoi në Drenas si mjek i përgjithshëm dhe më vonë specialist i kësaj fushe. Një kohë ishte edhe drejtor i Shtëpisë së Shëndetit në Drenas. Gjatë muajve të parë të luftës, bashkë me familjen dhe me popullsinë vendore u vendos në malësinë e Gradicës. Shkolla fillore e fshatit ishte shndërruar në spital të UÇK-së. L. Uka e drejtoi këtë spital të improvizuar së bashku me bashkëshorten, Eminen (infermiere) dhe me disa mjekë dhe infermierë vendorë. Në një nga fushatat e ushtrisë dhe policisë serbe u kap dhe, pasi u torturua në mënyrë barbare, u ekzekutua më 25 shtator të vitit 1998. Batalioni i 40-të i Mjekësisë pas luftës e mori emrin e këtij dëshmori. (Ali Lllunji)

UKA Mehë (1962-1996). Veprimtar i çështjes kombëtare, i burgosur politik, Hero i Kosovës. Lindi në fshatin Bajgorë të komunës së Mitrovicës. Që kur ishte nxënës në gjimnazin e Prishtinës mori pjesë në demonstratat e vitit 1981 dhe u dënua me dy muaj burg. Në prill të vitit 1982 u burgos për herë të dytë dhe u dënua me 18 muaj burg. Në vitin 1984, kur ishte duke kryer shërbimin ushtarak në Kumanovë, u arrestua sërish dhe u dënua me 7 vjet e gjysmë burg. Në vuajtje të dënimit u mbajt deri në dhjetor 1990, kur u lirua me amnisti të përgjithshme. Pas daljes nga burgu u regjistrua në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore dhe u zgjodh kryetari i parë i Unionit të Pavarur të Studentëve të Universitetit të Prishtinës. Në periudhën 1993-1996 punoi në shkollën fillore në Bajgorë. Më 1994 u burgos sërish dhe u dërgua në Burgun Ushtarak

të Nishit, prej nga u lirua pas 2 muajsh, pasi pagoi një shumë parash. Më 1996 u inkuadrua në radhët e Lëvizjes Kombëtare për Çlirimin e Kosovës, ku iu besua detyra e koordinatorit me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, si dhe u ngarkua për përgatitjen e një platforme të përbashkët për luftë çlirimtare. Në dhjetor të vitit 1996 u vra nga policia serbe në një pritë në fshatin Lushtë, në jugperëndim të Mitrovicës. Nga presidentja e Kosovës u dekorua me Urdhrin "Hero i Kosovës". (Miftar Kurti)

UKA Sabit (1920-2006). Historian, mësimdhënës. Lindi në Sllatinë të Madhe të komunës së Fushë-Kosovës. Më 1940, si ushtar i Jugosllavisë së vjetër u zu rob nga nazistët dhe mbeti



SABIT UKA

në internim deri në vitin 1945. Shkollën normale e kreu më 1949. Deri në vitin 1968 punoi si mësues, zëvendës drejtor, drejtor shkolle, inspektor i arsimit në Bardh të Madh, Shtime, Graçanicë e Prishtinë. Në vitin 1955 kreu Shkollën e Lartë Pedagogjike në Nish, kurse më 1967 u diplomua në degën e historisë në Fakultetin Filozofik të Shkupit. Prej vitit 1968 e deri më 1983 udhëhoqi Qendrën për Kualifikimin e Punëtorëve dhe Nxënësve, e cila më vonë u ngrit në shkollën e mesme teknike "Shtjefën Gjeçovi" në Prishtinë. Më 1979 kreu studimet pasuniversitare në degën e historisë të Fakultetit Filozofik në Prishtinë, ndërsa më 1993 mbrojti tezën e disertacionit. Nga vitet '90 të shekullit të kaluar e deri në fund të jetës iu përkushtua studimit të shpërnguljes me dhunë të shqiptarëve nga sanxhaku i Nishit dhe gjenocidit serb mbi popullsinë e këtyre viseve. Përveç punimeve të shumta në revistat shkencore, botoi disa vepra monografike: "Dëbimi i shqiptarëve nga Sanxhaku i Nishit dhe vendosja e tyre në Kosovë 1877/1878-1912" (në 3 vëllime), "Jeta dhe veprimtaria e shqiptarëve të Sanxhakut të Nishit" (në 4 vëllime) "E drejta mbi vatrat dhe pasuritë reale dhe autoktone nuk vjetrohët" etj. (Fitim Rifati)

UKA-BLAKÇORI Afrora (1972-). Grafiste. Lindi në Prishtinë, ku kreu shkollën fillore dhe të mesme, ndërsa studimet për grafikë i kreu në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës

(1994). Mbaroi studimet pasuniversitare më 1996. Ishte njëra ndër tre magjistrantët e parë të grafikës në Universitetin e Prishtinës. Punon me teknikën e shtypit të thellë, të akuatintës dhe të bakërshkrimit, me një kolorit intensiv, plot dritë, kryesisht me ngjyra bazike dhe forma të modeluara me ngjyrë të zezë. Motivet që i trajton janë asociative, marrë nga natyra. Mbajti një sërë ekspozitash personale: në Cyrih (1993), në Antalia (2000, 2002), në Prishtinë (1990, 1993), në Prizren (Galeria "Rada", 1996), në Galerinë e Arteve të Kosovës në Prishtinë (1996) etj. Mori pjesë në mbi tridhjetë ekspozita të përbashkëta, në vend dhe jashtë dhe është fituese e çmimeve për grafikë në Sallonin XXII të Nëntorit (1995) dhe në Sallonin XXIV (1997). (FatmirKrypa)

UKAJ Alban (1980-). Aktor. Lindi në Prishtinë, ku kreu shkollimin fillor dhe të mesëm. Studimet për aktrim i filloi në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës dhe, më



ALBAN UKAJ

tutje, prej 2001-2004, i vazhdoi në Fakultetin e Arteve Performative, në Sarajevë (Bosnjë e Hercegovinë). Fillimisht luajti në Teatrin "Dodona" dhe më pas në Sarajevë në teatrot: Skena e Hapur "Obala", Festivali MESS, Teatri Kombëtar i Sarajevës, Teatri kamertal 55, SARTR dhe në disa produksione të pavarura teatrore në Serbi dhe Mal të Zi. Ka luajtur në shfaqjet: "Murlin Murlo", "Cleansed", "Emigrantët", "Masë për masë", "Othello", "I burgosuri i rrugës së dytë", "Kthimi në shkretëtirë", "Adam Geist", "Motra e katërt", "Konspiracioni i madh i bardhë", "Hanibali i nëntokës", "Nusja nga shiu", "Aristoteli në Bagdad", "Ana Karenina", "Këngëtarja tullace", "In Flame", "Rrena e Tiresias", "Rikardi III", "Hipermnazia", "Kokos", "Armiku i popullit", "Romeo e Zhuljeta" etj. Prej 2001 ka luajtur në disa filma të metrazhit të gjatë të produksioneve boshnjake, shqiptare dhe ndërkombëtare, të tillë si: "Zjarri djeg", "Notre Musique", "Syri magjik", "Krejt falas", "Dub", "Heshtja e Lornës", "Rojet e natës", "Në rrugë", "J.A.C.E", si dhe në disa filma të metrazhit të shkurtër. U nderua me çmime të ndryshme: çmimi për aktorin e ri më të mirë në Festivalin e Dramës në Zenicë

(2004 dhe 2014), çmimi për aktorin më të mirë në Bosnjë e Hercegovinë nga Fondacioni “Mirna Filipan” (2008) etj. Më 2014, me filmin e shkurtër “Kali” (skenarist dhe bashkëregjisor), në Festivalin e filmit të shkurtër “20minmax” në Ingolstadt (Gjermani), fitoi çmimin e kompanisë “Audi AG” (2015). Jeton dhe punon në Sarajevë. (Bekim Lumi)

UKAJ Bajram (1950-). Jurist, profesor universitar. Lindi në Vranoc të Vogël të Deçanit, shkollimin fillor e kreu në vendlindje, të mesmen në Pejë, ndërsa Fakultetin Juridik në



BAJRAM UKAJ

Universitetin e Prishtinës (UP). Fillimisht punoi në komunën e Pejës, pastaj si gjyqtar në Gjykatën Komunale për Kundërvajtje. Në vitin 1981 u zgjodh asistent në Fakultetin Juridik të UP-së në lëndën e drejta penale. Studimet pasuniversitare i kreu po në këtë fakultet, ku edhe doktoroi në vitin 2005. Gjatë vitit 1995-2000 mbajti ligjërata edhe në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës. Është autor i monografisë “Dënimet në të drejtën penale të Shqipërisë” Pas futjes së masave të dhunshme në Universitetin e Prishtinës mori pjesë në aktivitetin e Unionit të Pavarur të Studentëve të Fakultetit Juridik të UP-së, në veçanti për konstituimin e Sindikatës së Pavarur të Fakultetit dhe të Universitetit. Kreu detyrën e prodekanit dhe për dy mandate të dekanit të Fakultetit Juridik. Është anëtar i Këshillit Prokurorial të Kosovës. (Ejup Sahiti)

UKAJ Ndue (1077-). Poet. Lindi në Stubëll të Epërme të Vitisë. Kreu studimet për letërsi e gjuhë shqipe në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës. Gjatë studimeve ka qenë aktiv në organizatat studentore, anëtar i redaksisë së revistës “Fryma”, pastaj editor i revistës “Identiteti”. Ishte i angazhuar edhe në veprimtarinë e Partisë Shqiptare Demokristiane të Kosovës dhe në Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sporteve (MKRS). Në vitin 2004 ka botuar librin “Diskursi bibliik në letërsinë shqipe”. Më pas ka botuar librat me poezi: “Ujëvarat e metaforave” (2008), “Godo nuk vjen” (2010), në shqip, anglisht dhe spanjisht, “Arka e shpëtimit” (2012), “Gjithmonë diçka mungon” (2017).

Në vitin 2010 në SHBA është botuar në gjuhë angleze libri me poezi “Itaka e fjalës” (Ithaca of the word). Poezitë e tij janë prezantuar në revista të specializuara dhe në disa antologji. Për përmbledhjen “Godo nuk vjen” ka marrë Çmimin “Azem Shkreli” të MKRS-së për librin më të mirë me poezi. (Munish Hyseni)

UKAJ Shefki (1949-). Gazetar. Lindi në Dobrajë të Madhe, komuna e Lipjanit. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, të mesmen në Prishtinë, studimet për politikologji dhe gazetari në Zagreb. Në vitet 1974-1979 punoi gazetar në “Vjesnik” dhe “Večernji list” në Zagreb, ndërsa më vonë (1979-1994) ishte korrespondent i këtyre gazetave nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia dhe Mali i Zi. Në periudhën 1994-2004 ishte edhe redaktor-gazetar në Qendrën për Informim të Kosovës, si dhe gazetar-koordinator në gazetën “Bota sot”, më pas këshilltar politik në Ministrinë e Transportit dhe të Telekomunikacionit dhe në Ministrinë e Kulturës, të Rinisë dhe të Sportit. Në vitet 2012-13 ishte kryetar i Komisionit të Pavarur për Medie të Kosovës. Gjatë punës si gazetar bashkëpunoi edhe me mediet e huaja, si: me Radio Nacionale të Suedisë, me Radio Televizionin e Zagrebit, Radio Melbourne e Australisë etj. Është autor i monografisë: “Krimet serbe në Komunën e Lipjanit (1912-1999)”. (Ibrahim Berisha)

UKAJ Vezir (1942-). Shkrimtar. Lindi në fshatin Dobrajë e Madhe të Lipjanit. Mësimet e para i mori në vendlindje, shkollën e mesme dhe studimet për gjuhë e letërsi shqipe i kreu në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prishtinë. Në vitin 1963 u burgos për bindje politike. Pas lirimit nga burgu, punoi në Redaksinë e revistave të “Rilindjes” si daktilograf dhe më pas korrektor. Së fundi, në vitet nëntëdhjetë, punoi si gazetar dhe redaktor në revistën “Shkëndija”. Me krijimtari letrare u mor qysh herët. Botoi vjersha, ndonjë prozë dhe artikuj publicistikë. Deri më tash ka botuar vëllimet me poezi: “Dhoma numër katër”, “Bush”, “Sërish”, “Atëherë” etj. (Hasan Hasani)

UKELLA Sadik (1934-1992). Veteran i arsimit, novator. Lindi në Pejë, ku kreu edhe shkollën fillore. Shkollën e mesme e filloi në Pejë dhe e përfundoi në Prishtinë. Studimet për pedagogji i vijoi në Fakultetin Filozofik

të Universitetit të Shkupit. Punoi si mësues dhe këshilltar pedagogjik në Pejë. Ishte edhe sekretar, përkatësisht nëpunës në BVI-në e arsimit dhe të kulturës. Ishte metodist i shquar dhe autor i racionalizatorit SU-1, si mjet universal për konkretizimin, racionalizimin dhe integrimin e mësimit. Për përdorimin e tij autori hartoi edhe një doracak të veçantë. Është edhe autor i një metodike të mësimit të lexim-shkrimit fillestar. (Izet Musaj)


UKELLI Hajredin (1937-1997). Mjek, kirurg i fëmijëve, profesor universiteti. Lindi në Shajkoc të Podujevës, shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa gjimnazin në Prishtinë. Kreu



HAJREDIN UKELLI

studimet në Fakultetin e Mjekësisë në Shkup (1963). U punësua në Spitalin e Përgjithshëm të Prishtinës dhe më pas u dërgua në Orllan, ku hapi shtëpinë e parë të shëndetit dhe u emërua drejtor i saj. Kreu specializimin për kirurgji të fëmijëve në Beograd dhe u emërua kryeshef i repartit të porsahapur të kirurgjisë së fëmijëve. U zgjodh asistent, më pas docent, profesor inordinar dhe në vitin 1993 mori titullin dhe profesor ordinar i lën-dës së kirurgjisë në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës. Gjatë punës mbi 30-vjeçare kreu detyra me përgjegjësi në institucionet arsimore dhe shëndetësore. Mori pjesë në shumë takime profesionale dhe publikoi një sërë punimesh shkencore. Është autor i disa librave në fushë të profesionit: “Zbulimi dhe shërimi i hershëm i anomalive kongjenitale më të shpeshta të sistemit lokomotor” (1989), “Indikacionet për ndërhyrje kirurgjike të thyerjet e diafizave të eshtrave të gjatë të ekstremiteteve të poshtme të fëmijët” (1989), “Sëmundjet më të shpeshta kirurgjike të fëmijëve” (1996). (Avdyl Krasniqi)

UKMATA Hysen (1928-2008). Mjek, internist, endokrinolog, profesor universiteti. Lindi në Gjakovë, shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa gjimnazin në Mitrovicë. Mbaroi studimet në Fakultetin e Mjekësisë në Beograd (1958). U emërua mjek i përgjithshëm në Shtëpinë e Shëndetit në Gjakovë dhe drejtor i kësaj qendre deri më 1961. Përfundoi specializimin nga lëmi i mjekësisë interne gjithashtu në Beograd



HYSEN UKMATA

dhe më pas punoi në Spitalin e Përgjithshëm në Prishtinë. Në vitin 1967 vazhdoi subspecializimin për endokrinologji në Fakultetin e Mjekësisë në Romë. Themeloi shërbimin endokrinologjik të Klinikës Interne dhe u emërua kryeshef i shërbimit. Mbrojti tezën e disertacionit të doktoraturës në Fakultetin e Mjekësisë në Beograd (1976), ndërkohë në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë mori titujt përkatës universitarë, përfshirë titullin profesor ordinar (1983). Mori pjesë në forume të ndryshme shkencore profesionale në vend dhe jashtë vendit. Ishte anëtar i Këshillit Shkencor për Studime të Diabetit në ish-Jugosllavi dhe anëtar i Forumit European për Studimet e Diabetit (EASD). Gjatë vitit 1991/92 ishte njëri ndër iniciatorët për rifillimin nga puna të Fakultetit të Mjekësisë jashtë objekteve të veta. Gjatë luftës emigroi me familje në Zelandën e Re. Pas luftës u kthye në Klinikën Interne dhe ndihmoi riorganizimin e klinikës dhe të procesit mësimor. (Ymer Elezi)

UKSHINI Emrullah (1963-). Publicist. Lindi në Kumanovë, ku kreu shkollimin fillor dhe të mesëm. U diplomua në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës, kurse studimet pasuniversitare i kreu në Universitetin e Shkupit. Prej vitit 1986 u përfshi në Lëvizjen për Republikën e Kosovës (LPRK). Në vitin 1993 angazhohet në degën e Partisë së Prosperitet Demokratik Shqiptar në Kumanovë. Më 2001 i bashkohet Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare dhe në vitin 2002 kalon në Bashkimin Demokratik për Integrim. Më 2005 themeloi Partinë “Forcat e Reja Demokratike”. Shkroi për gazetën e studentëve “Bota e re”, “Flakën e vëllazërimit” etj. Është autor i librave “Ndikimi i islamit në kulturën politike të shqiptarët në Republikën e Maqedonisë” (2009) dhe “Demokracia brendapartiake, struktura e partive politike shqiptare në Maqedoni” (2013). Jeton në Kumanovë. (Muhamet Mavraj)

UKSHINI Sami (1978-2001). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare për Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë (UÇPMB), dëshmor. Lindi në fshatin Zhegër të Gjilanit. Në vitin 1998 emigroi në

Zvicër. Pas çlirimit të Kosovës më 1999 dhe fillimit të luftës në Preshevë, në qershor të vitit 2000 iu bashkua radhëve të UÇPMB-së. Veprimi në kuadër të njësitit për ndërhyrje të shpejtë të Brigadës 113 "Ibrahim Fejzullahu" të Zonës Operative të Preshevës. Mori pjesë në betejën e Shoshajës dhe atë të Rahovicës. Më 14 maj 2001, derisa ishte në ekipin e transportimit të të plagosurve nga beteja e Rahovicës për në Maxhere, u vra te penda e Rahovicës. (Fehari Ramadani)

UKSHINI Sylë (1965-). Publicist, historian. Lindi në Komogllavë të Ferizajt. Shkollimin fillor e kreu në vendlindje, të mesmin në Ferizaj. Ndoqi studimet për histori dhe marrëdhënie ndërkombëtare në Universitetin e Prishtinës dhe i vazhdoi në Universitetin e Lirë të Berlinit (Gjermani), më pas në Universitetin e Vjenës dhe të Gracit në Austri. Studimet e doktoraturës për integritet europian dhe marrëdhënie ndërkombëtare i përfundoi në Universitetin e Bremenit (Gjermani). Pas vitit 1999 punoi në Arkivin e Kosovës dhe në Ministrinë e Jashtme. Nga qershori i vitit 2014 është diplomat në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Tiranë. Shkrimet e para i botoi në vitet 1989-1990 nga fusha e historiografisë te gazeta "Rilindja" dhe "Zëri". Ndërkaq, në vitet 1996-1999 ishte bashkëpunëtor i gazetës "Bujku", pastaj i gazetës "Koha ditore", ndërsa në vitet 2000-2002 kolumnist i pavarur në gazetën "Epoka e re", "Fakti", "Eurozëri", "Zëri" etj. Botoi librat publicistikë dhe studimorë: "Kosova dhe Perëndimi" (2001), "Refleksione historiografike" (2002), "Nga lufta në paqe" (2004), "Një vit vendimtar" (2008), "Kosova në politikën e jashtme të BE-së" (2008) etj. (Ibrahim Berisha)

UKSHINI Shaban (1969-2001). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) dhe i Ushtrisë Çlirimtare për Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë (UÇPMB), dëshmor. Lindi në fshatin Zhegër të Gjilanit. Gjatë luftës së Kosovës u angazhua për strehimin dhe mirëmbajtjen e armatimit për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës të Zonës Operative të Karadakut. Pas mbarimit të luftës së Kosovës, së bashku me bashkëluftëtarët u angazhua në përgatitjen e njësiteve ushtarake të UÇPMB-së. U emërua komandant i batalionit II të Brigadës 113 "Ibrahim Fejzullahu" të Zonës Operative të Preshevës dhe mori pjesë në betejën e Shoshajës dhe të Rahovicës. Gjatë

luftimeve në Rahovicë, më 14 maj 2001 u plagos dhe derisa po transportohej për në Maxhere, te penda e Rahovicës u vra në një pusi që i kishin ngritur forcat serbe. (Fehari Ramadani)

ULAJ Idriz (1942-). Mbledhës i folklorit, gazetar, shkrimtar. Lindi në Vuthaj, Mal të Zi. Kreu Shkollën Normale në Prizren, studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe i përfundoi në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës (1969). Punoi si mësimdhënës në disa shkolla fillore dhe të mesme të Prishtinës, kurse nga viti 1972 deri më 2007 ishte lektor dhe gazetar në revistën javore "Zëri i rinisë". U mor me mbledhjen, klasifikimin e botimin e folklorit dhe të etnologjisë. Ka botuar disa studime mbi gjenezën e shqiptarëve të Plavës e Gucisë dhe ka përkthyer nga gjuha malazeze dy libra etnografikë-historikë për Malësinë e Madhe dhe për krahinën e Plavës e të Gucisë. Nga fusha e folklorit botoi veprat "Këngë popullore nga Gucia", "Këngë dhe vajtime nga krahina e Plavës dhe Gucisë", "Prozë popullore nga krahina e Plavës dhe Gucisë" etj. Ka botuar edhe përmbledhjen poetike "Prizma", si edhe një numër krijimesh të tjera në prozë e në publicistikë. (Vlorë Fetaj-Berisha)

ULPIANA. Vendbanim i periudhës romake, i njohur dhe si Justiniana Secunda. Ndodhet rreth 8 km në juglindje të Prishtinës. U njoh nga burimet antike, u dëshmuar në një sërë mbish-



UNAZA E ULPIANËS

krimesh epigrafi-ke dhe u përmend nga shumë udhëpërshkrues të kohës. U themelua në shek. I te vendbanimi i mëherëshëm dardan (oppidum) dhe gjatë sundimit të perandorit Trajan (98-117) u ngrit në rang të municipit, kur dhe mori emrin Ulpiana. Qyteti hyri në mesin e qendrave të rëndësishme ekonomike dhe politike të Ballkanit Qendror, duke qenë i rrethuar me komplekse të rëndësishme xehetare, të pasura me ar, argjend dhe plumb dhe se gjendej në udhëkryq të rrugëve që lidhnin Lindjen me Perëndimin. Pak të dhëna ka për impaktin politik dhe ekonomik të qytetit gjatë shek. I, por sundimi i perandorit Trajan dhe reformat urbanistike ndikuan në zhvillimin e Ulpianës dhe shndërrimin e saj në qendër të rëndësishme

politike dhe ekonomike për tërë rajonin. Në shek. II-III u vërsua dhe nga flukse të ardhurish romakë, në mesin e tyre dhe të familjeve senatoriale romake Furi dhe Ponti. Këta i lidhën interesat ekonomike me Ulpianën në fushën e xehetarisë dhe të bujqësisë. Kulmi i zhvillimit u arrit në shek. II-IV, kur u shndërrua në qendër të rëndësishme politike, ekonomike, kulturore dhe religjioze të një hapësire të gjerë gjeografike. Ulpiana kishte karakteristikat e qytetit të vërtetë romak, me mure rrethuese, sistem ortogonal të rrugëve, ujësjellës, kanalizime dhe objekte luksoze publike dhe private. Ishte qendër e rëndësishme artizanale, tregtare dhe bujqësore dhe fitoi epitelin “municipi madhështor i Ulpianës” (Municipii splendissimii Ulpianae).

Me Ulpianën lidhen dhe fillet e krishterimit në Dardani përmes martirizimit të vëllezërve binjakë, Shën Florit dhe Shën Laurit (shek. II). Ulpiana u bë dhe qendër e rëndësishme kishtarë. Gërmimet arkeologjike nga viti 1954 nxorën në dritë pjesë të murit rrethues me kulla mbrojtëse, kastrumin, pjesë të rrugëve kardo dhe dekumanus, mbetjet e tempullit pagan, baptisterin, dy bazilika, pjesë të vilave urbane e të portikëve, komplekse artizanale, nekropolin verior dhe perëndimor etj. Me gjithë goditjet e pësuar nga fiset barbare në shek. III-V, krizës ekonomike dhe politike në Perandorinë Romake, si dhe tërmetit të vitit 518, Ulpiana mbijetoi dhe u rindërtua me madhështinë e vjetër falë perandorit bizantin Justinianit, i cili i dha emrin e ri, Justiniana Secunda. Ulpianën e ubifikoi arkeologu E. Çershkov dhe nisi hulumtimet në të në vitin 1954. (Arben Hajdari)

ULQINAKU Hafiz Ali Riza (1853-1913). Mësues, imam, përkthyes, gjuhëtar. Lindi në Ulqin. Mësimet i mori në Medresenë e Ulqinit dhe të Shkodrës. Ishte mësues në Dudas, pastaj në Lezhë, ku u bë edhe imam e myfti. Veprimtaria e Hafiz Ali Ulqinakut shtrihet në disa fusha. Përktheu dhe përshtati “Mevludin” nga poeti i famshëm turk Sulejman Çelebi dhe hartoi tre fjalorë turqisht-shqip dhe shqip-turqisht. Fjalorët i shkroi në vargje dhe i përmbloodhi në një vepër me titull “Ulqini”. Të tre së bashku kanë gjithsej 1,334 faqe. Hartoi edhe një abetare shqipe me alfabet arab. Në veprat e tij përdori alfabetin arab, të cilin e modifikoi, duke përfshirë edhe bashkëtingëlloret që nuk i ka shqipja. Alfabetin me 40 shkronja e përshtati për sistemin fonetik të gjuhës shqipe. (Jahja Hundozi)

ULQINAKU Hajro (1938-). Shkrimtar, publicist, përkthyes. Lindi në Ulqin, ku mbaroi shkollën fillore. Kreu shkollën e mesme në Prishtinë, kurse studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Beograd. Punoi si mësues në Ostros, mësimdhënës dhe këshilltar pedagogjik në Ferizaj, redaktor i emisioneve për fëmijë në Televizionin e Prishtinës. Bëri emër kryesisht si shkrimtar për fëmijë, duke botuar përmbledhje tregimesh, pjesë teatrale dhe romane të shkurtra. U mor edhe me botimin e folklorit të trevës së Ulqinit. Botoi disa vepra publicistike për detarët dhe peshkatarët ulqinakë dhe një fjalor të detarisë së Ulqinit. U mor edhe me përkthime letrare. Tematika e veprës së tij lidhet kryesisht me Ulqinin, detin dhe me jetën rreth tij. Nëpërmjet veprës së tij H. Ulqinaku u ofron fëmijëve një fjalor të atij mjedisi: mjetet e lundrimit, veglat e punës, mikrotoponominë e Ulqinit etj. Veprat e botuara: “Fëmijët e detit” (1967), “Mbrëmje pulëbardhash” (1978), “Thesari i piratëve” (1979), “Bukuria e detit” (1989), “Ishulli i gjelbër” (1999), “Limani i qetësisë” (1999), “Pylli i Dragoit” (2003) etj. (Arif Demolli)

ULQINI. Qytet bregdetar në jug të Malit të Zi të sotëm. Sipas legjendës, Ulqinin e kanë ndërtuar banorët e Kolhidës (Greqi). Së këndejmi, përgjatë antikitetit shpesh e ndeshim të quajtur



KALAJA E ULQINIT

Colchinium (krahas emrave të tjerë: *Olcinium*, *Ulcini*, *Licini*, *Ulkinion*, *Ulcinium*, *Licinium*, *Dolchin*, *Dulcinium*, *Dulcignum*, *Dulcigno*, *Dulcini*, *Dulceygno* etj). Gjatë periudhës antike qyteti ishte qendër e njohur ilire, për të rënë më 168 p.e.r. nën romakët, përkatësisht më 395 të erës sonë, nën Perandorinë e Bizantit. Në kohën e perandorit Justiniani I (527-

565), burimet materiale dhe tërthorazi ato të shkruara dëshmojnë se kalaja e qytetit ishte forcuar me mure të qëndrueshme. Në fund të shek. X, kalaja e Ulqinit u rezistoi sulmeve të mbretit bullgar, Samuil, dhe sulmeve mongole (1242). Në shek. XI, si komunë në vete bëhet pjesë e shtetit të Dioklesë, ndërkaq nga viti 1183 ra nën nemanjidët, pastaj në gjysmën e dytë të shek. XIV (1361) nën shtetin e Balshajve, të cilët së pari e caktuan si qendër të përkohshme dhe e shndërruan më pas nga viti 1396 në qendër të tyre rezidenciale. Republika e Venedikut e pushtoi Ulqinin në vitin 1421, ndërsa osmanët më 1571. Gjatë sundimit venedikas dhe osman depërtuan elemente të reja në strukturën arkitektonike dhe urbane të qytetit. Qyteti kishte të drejta dhe privilegje të vetadministrimit, deri te komuna autonome qytetare. Ulqini kishte statutin e tij, si shprehje më e lartë e organizimit komunal të qyteteve në mesjetë. Kishte noterin e vet, i cili krahas punëve juridike, kryente edhe detyrën e mësuesit. Dominikanët shqiptarë themeluan shkollën e studimeve pranë kuvendeve në Ulqin (1258). Në mesin e dominikanëve shqiptarë përmendet fratër Shtjefën Zaharia. Përmes rrugës së Zetës, Ulqini është lidhur mirë me qytete të Kosovës mesjetare. Më 1379 dhe 1380 në Prishtinë hasim Marin Nikollën, qytetar raguzan nga Ulqini. Gjatë gjysmës së parë të shekullit XV në Prishtinë kanë jetuar disa pjesëtarë të familjes bujare shqiptare Tani nga Ulqini. Prania e ulqinakëve vërehet edhe në Venedik dhe Dalmaci jo vetëm pas pushtimit osman (1571), por edhe pas rënies së Shkodrës (1479). Prania e tyre në Venedik ndeshet që nga gjysma e parë e shek. XIV dhe kryesisht janë marrë me veprimtari detare dhe zejtare. Kishte edhe priftërinj, si dhe të punësuar në shërbime shtetërore dhe tregtare. Ulqinaku Lukë Paneti në vitet 1517-1518 posedonte një shtypshkronjë dhe librari. Në Dalmaci, përkatësisht në Raguzë, mund të ndeshen mjaft ulqinakë, ku veçohen familjet bujare Gabro dhe Tani. Më 1331 shërbimin ipeshkvor në Raguzë e kryente ipeshkvi ulqinak Graciani. Në Universitetin e Gracit, më 1596 përmendet studenti shqiptar nga Ulqini, Johannes Mihilius. Nga disa dokumente raguzane dhe venedikase mësohet se Martin Segoni-Novobërdasi ishte ipeshkëv i Ulqinit. Ndërsa familjet e njohura bujare ulqinake, Bruni (Gjon dhe Gaspër Bruni) dhe Bruti (Bartolome, Kristofor e Anton Bruti) kishin

mbetur simbol i qëndresës ulqinake ndaj pushtimit osman më 1571.

Pushtimet osmane u shoqëruan edhe me ngulitjen në Ulqin të 400 kusarëve algerianë në krye me Eulg-Aliun. Nga kjo kohë Ulqini konsiderohej njëra ndër qendrat e mëdha të kusarëve në Adriatik. Kusarët ulqinakë plaçkitnin anijet nëpër Adriatik deri në shek. XVIII. Në vitet 1880-1916, sipas marrëveshjeve ndërkombëtare, Ulqini hyri në kuadër të Principatës, përkatësisht të Mbretërisë së Malit të Zi. Gjatë Luftës së Parë Botërore (1916-1918) kaloi në duar të Austro-Hungarisë dhe më pas, deri në vitin 1920, ishte pjesë e Italisë, vit që shënon përfshirjen e Ulqinit në Mbretërinë Serbe-Kroate-Slllovene. (Sami Gashi)

UNICEF (The United Nations Children's Fund - Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijë).

Është program i Kombeve të Bashkuara me seli në Nju-Jork, që ofron ndihmë afatgjate humanitare dhe zhvillimore për fëmijët dhe nënat në shtetet në zhvillim. U themelua nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) më 11 dhjetor 1946 për ndërhyrje emergjente për ushqim dhe kujdes shëndetësor të fëmijëve të shteteve të shkatërruara nga Lufta e Dytë Botërore. Më 1953 u bë pjesë e përhershme e sistemit të OKB-së dhe u pagëzua me shkurtesën UNICEF, me të cilën tashmë njihet në mbarë botën. U financua nga qeveritë dhe dhuruesit privatë. Aktiviteti i UNICEF-it është kryesisht në terren dhe mbështetet në zhvillimin e shërbimeve në komunitet për të promovuar shëndetin, mirëqenien dhe të drejtat e fëmijëve. UNICEF-i fitoi Çmimin Nobel për Paqe në vitin 1965. Programi menaxhohet nga Nju-Jorku, kurse divizioni i furnizimit gjendet në Kopenhagë. Në Kosovë UNICEF-i filloi të veprojë nga vitet '80, në sektorin e furnizimit të nxënësve të shkollave me ujë të pijshëm, ndërsa selia e programit u hap në Prishtinë në vitin 1997. Në periudhën 1999-2001 zgjeroi aktivitetin, duke hapur zyra në Gjiilan, Pejë, Prizren dhe Mitrovicë. Dha një kontribut të çmuar në rehabilitimin dhe zhvillimin e mbrojtjes shëndetësore në Kosovë. Që nga paslufta mbështet programet për nënën dhe fëmijën, programet në arsim etj. (Isme Humolli)

UNIONI I GAZETARËVE TË KOSOVËS (UGK). Asociacion i gazetarëve të Kosovës, i themeluar në vitin 2009, me nismën e një grupi gazetarësh të diplomuar për gazetari në

Universitetin e Prishtinës. Ideja e themelimit të kësaj organizate erdhi si rezultat i sfidave me të cilat u përballën gazetarët e Kosovës në këtë periudhë, për të qenë të organizuar në mbrojtje të fjalës së lirë dhe të drejtave të tyre. Objektivat kryesore të UGK-së janë mbrojtja e lirisë së shprehjes dhe lirisë së shtypit, mbrojtja e gazetarëve nga kërcënimet që mund të vijnë gjatë punës së përditshme, mbrojtja nga grupet e ndryshme të interesit etj. Një segment tjetër i objektivave të organizatës është ndihma profesionale për gazetarët, duke ngritur për diskutim tema rreth problematikave me të cilat përballen gazetarët gjatë raportimit profesional. (Artan Krasniqi)

UNIVERSITETET POPULLORE DHE TË PUNËTORËVE. Universitetet popullore ishin institucione për ngritjen arsimore dhe kulturore të të rriturve, ndërsa universitetet e punëtorëve ishin institucione për arsimin të vazhdueshëm të të rriturve, për plotësimin e nevojave të tyre, sidomos të punonjësve për arsim. Përveç programeve profesionale, universitetet e punëtorëve ofronin edhe përmbajtje të tjera, me çka u afroreshin universiteteve popullore. Universitetet e para popullore u paraqiten në gjysmën e dytë të shek. XIX në vendet skandinave, ndërsa në Kosovë filluan të themelohen nga vitit 1946, në qendra më të mëdha: Mitrovicë, Prishtinë, Prizren, Pejë, Gjilan etj., të cilët zhvilluan veprimtari edhe në mjedise të tjera më të vogla. Luajtën rol të rëndësishëm në ngritjen kulturore, arsimore dhe në emancipimin e popullsisë kosovare. Universitetet e punëtorëve në Kosovë, ndërkaq, filluan të themelohen në vitin 1952. Veprimtaria arsimore e tyre u përqendrua në arsimimin dhe edukimin shoqëror dhe politik të punëtorëve, në arsimimin dhe aftësimin për punë dhe në arsimimin e përgjithshëm të të rriturve. Në periudhën 1950-1958 u bë një riorganizim i universiteteve popullore, ndërsa nga viti 1960 u zvogëlua numri i universiteteve të punëtorëve dhe roli i tyre për shkak se u vendos që organizatat ekonomike të themelojnë qendra për arsimin profesional të punëtorëve. (Demë Hoti)

UNIVERSITETI AMERIKAN I KOSOVËS (AUK). Universitet privat me seli në Prishtinë, me studime universitare amerikane, në partneritet me Rochester Institute of Technology



UNIVERSITETI AMERIKAN I KOSOVËS

të Nju-Jorkut (RIT). U themelua në vitin 2002, filloi punën në shtator 2003. Ky universitet përgatit kadro të profileve të ndryshme, të njohura ndërkombëtarisht. Përbëhet nga këto drejtime: ekonomi dhe statistikë, menaxhim, multimedia dhe komunikim vizual dhe politikat publike. Në kuadër të tij funksionon edhe Instituti i Trajnimit dhe Zhvillimit, i cili ofron kurse dhe certifikata të pranuar ndërkombëtarisht nga teknologjia e informacionit, menaxhimi i biznesit dhe gjuha angleze. Mësimi në këtë universitet zhvillohet në gjuhën angleze. Fillimisht kishte 57 studentë, por në vitin 2014/15 numri i tyre shkoi në 550. Përveç studentëve shqiptarë nga Kosova, studimet në AUK i ndjekin edhe një numër studentësh nga 17 vende të tjera të botës, nga SHBA-ja, Gjermania, Zvicra etj. (Selim Mehmeti)

UNIVERSITETI I EUROPËS JUGLINDORE (UEJL), TETOVË. U themelua në vitin 2001, me nismën dhe ndihmën e donatorëve ndërkombëtarë, si kompromis, për të krijuar alternativën legale të Universitetit të Tetovës, legalizimi i të cilit refuzohej kategorikisht nga shteti maqedonas. Kjo ngarkesë politike gradualisht u hoq dhe UEJL-i mbeti një institucion i rëndësishëm i shkollimit të lartë në Maqedoni, një qendër arsimore që përgatit kadro të kualifikuara në fusha të ndryshme. Në përbërje të UEJL-it tani janë: Fakulteti i Drejtësisë, i Administratës Publike dhe i Administrimit të Biznesit (në drejtimin ekonomi dhe të financa); Fakulteti i Shkencave dhe i Teknologjive të Komunikimit, si dhe Fakulteti Pedagogjik (me departamentet e gjuhës dhe të studimeve shqipe, maqedonase, angleze, franceze dhe gjermane). Në kuadër të UEJL-it funksionon Qendra Kompjuterike dhe Qendra e Gjuhëve.



UNIVERSITETI I EUROPËS JUGLINDORE NË TETOVË

Përveç studentëve shqiptarë dhe maqedonas nga Maqedonia, në këtë universitet i ndjekin studimet edhe një numër i konsiderueshëm i studentëve nga Kosova dhe viset e tjera shqiptare. (Xheladin Murati)

UNIVERSITETI I GJAKOVËS. Universiteti publik “Fehmi Agani” në Gjakovë u themelua në vitin 2013. Ka tre fakultete: Fakultetin e Edukimit, me dy programe: parashkollor dhe



UNIVERSITETI I GJAKOVËS

shkollor; Fakultetin e Mjekësisë, me dy programe: infermieri dhe mami dhe Fakultetin e Filologjisë me dy programe: gjuhë shqipe dhe gjuhë e letërsi angleze. Në këtë universitet organizohen studimet e nivelit themelor (baçelor) dhe zgjasin 3-4 vjet. Në Universitetin “Fehmi Agani” të Gjakovës i vijnë mësimit studentë nga Gjakova me rrethinë dhe nga trevat veriore të Shqipërisë. (Afërdita Deva-Zuna)

UNIVERSITETI I GJILANIT. Universiteti “Kadri Zeka” në Gjilan u themelua në vitin 2013. Përbëhet prej katër njësive akademike, me programe përkatëse: Fakulteti i Edukimit, me



UNIVERSITETI I GJILANIT

programet parashkollor dhe fillor e parafillor; Fakulteti Juridik, me programin e përgjithshëm; Fakulteti Ekonomik, me programet banka, financa dhe kontabilitet, menaxhment dhe informatikë, marketing; Fakulteti i Shkencave Kompjuterike me programin e shkencave kompjuterike. Në të gjitha fakultetet studimet janë në nivelin baçelor, ndërsa në Fakultetin Ekonomik realizohet edhe programi për master në administrim biznesi. (Januz Dervodeli)

UNIVERSITETI I MITROVICËS. Universiteti publik “Isa Boletini” në Mitrovicë u themelua në vitin 2013. Pararendës i tij ishte Fakulteti i Shkencave të Aplikuara në këtë qytet. Në



UNIVERSITETI I MITROVICËS

kuadër të Universitetit të Mitrovicës funksionojnë tri fakultete: Fakulteti i Inxhinierisë Mechanike dhe Kompjuterike, me programe për baçelor dhe drejtimet: makineri prodhuese, informatikë inxhinierike, inxhinieri ekonomike dhe master me drejtimet: teknologji prodhuese dhe informatike inxhinierike; Fakulteti i Gjeoshkencave, me programe për baçelor me drejtimet: xehetari; gjeologji, materiale dhe

metalurgji dhe master me drejtimet: xehetari e përgjithshme, vendburimet e lëndëve të para minerale, hidrogjeologji dhe gjeologji inxhinierike etj.; dhe Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore me drejtimet: inxhinieri ushqimor, inxhinieri e mbrojtjes së mjedisit dhe inxhinieri kimike. (Afërdita Kumnova-Mulla)

UNIVERSITETI I PEJËS. Universiteti publik “Haxhi Zaka” në Pejë u themelua në vitin 2011. Përbëhet prej këtyre fakulteteve: Fakulteti i Biznesit, Fakulteti Juridik, Fakulteti për Mena-



UNIVERSITETI I PEJËS

xhment, Turizëm, Hotelieri, Fakulteti i Agrobiznesit dhe Fakulteti i Arteve. Mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe dhe boshnjake. Studentët e këtij universiteti janë kryesisht nga Rrafshi i Dukagjinit, nga trojet shqiptare në Malin e Zi dhe nga Shqipëria Veriore etj. (Demë Mulliqi)

UNIVERSITETI I PRISHTINËS. Institucioni kryesor i arsimit të lartë në Kosovë, me seli në Prishtinë. U themelua më 15 shkurt 1970, në bazë të Ligjit mbi themelimin e Universitetit të Prishtinës, miratuar nga Kuvendi i KSA të Kosovës më 18 nëntor 1969. Në përbërje të tij hynin: Fakulteti Filozofik, Fakulteti Juridik-Ekonomik, Fakulteti Teknik dhe Fakulteti i Mjekësisë, si dhe fakultete të tjera, të themeluara në vitet 1970-1980, shkollat e larta, sipas marrëveshjes së vitit 1980. Gjithsej: 14 fakultete dhe 7 shkolla të larta. Në vitin e parë akademik 1969/70 në këtë universitet studioinin 7,712 studentë (5,303 të rregullt, 2,409 me korrespondencë), prej të cilëve 3,669 shqiptarë e 4,043 serbë. Numri i studentëve, sidomos i atyre shqiptarë, vazhdon të rritet. Në vitin akademik 1980/81 në Universitetin e Prishtinës vijonin studimet 31,073 studentë me mësim



REKTORATI I UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS

në gjuhën shqipe, 12,248 me mësim në gjuhën serbokroate dhe 223 shtetas të huaj. U rrit, gjithashtu, edhe numri i vajzave studente. Universiteti i Prishtinës ia filloi punës me rreth 200 mësimdhënës dhe rreth 200 bashkëpunëtorë, ndërsa në vitin akademik 1979/80 kishte rreth 600 mësimdhënës dhe 400 bashkëpunëtorë, shumica prej tyre shqiptarë. Për shkak të mungesës së kuadrit arsimor, u angazhuan edhe mësimdhënës të universiteteve të Beogradit, të Shkupit, të Nishit etj. Në vitin 1970 filloi bashkëpunimi midis Universitetit të Prishtinës dhe atij të Tiranës, i cili u intensifikua sidomos në vitet 1978-1981, kur shumë mësimdhënës nga Universiteti i Tiranës mbajnë ligjërata në Universitetin e Prishtinës. Në disa fakultete u themeluan edhe studimet pasuniversitare. U intensifikua edhe veprimtaria kërkimore-shkencore dhe botimi i teksteve universitare nga mësimdhënësit e Universitetit të Prishtinës. Përmirësohet standardi i studentëve dhe veprimtaria sportive dhe argëtuese e tyre. Studentët botonin revistat e tyre “Bota e re” dhe “Dituria”. Në vitet 1970-1980 në Universitetin e Prishtinës diplomuan rreth 9,500 studentë në 46 profile. U mbrojtën rreth 100 disertacione të doktoratave.

Pas demonstratave të studentëve të vitit 1981, nga autoritetet politike Universiteti i Prishtinës u cilësua si “çerdhe e nacionalizmit dhe e irredentizmit shqiptar” dhe filloi të ndërmerret një fushatë e gjithanshme kundër tij. Për shkaqe politike dhe ekonomike numri i studentëve filloi të zvogëlohej, nga procesi mësimor u përjashtuan disa mësimdhënës dhe bashkëpunëtorë etj. Kjo arriti kulmin me vendimin e Kuvendit të Republikës së Serbisë (27 qershor 1991) për aplikimin e “masave të përkohshme” në Universitetin e Prishtinës. Më 1 tetor 1991 u

ndërpre financimi i mësimi shqip në të gjitha fakultetet dhe shkollat e larta të Universitetit të Prishtinës. Nga Universiteti u përjashtuan mësimdhënësit dhe studentët shqiptarë, të cilët i refuzuan masat diskriminuese serbe. Studimet në gjuhën shqipe në Universitetin e Prishtinës u ndërpre në përfundimisht. Mbështetur në dispozitat ligjore të institucioneve të Kosovës, Kuvendi i Universitetit të Prishtinës më 26 nëntor 1991, vendosi që ky institucion ta organizojë mësimin në gjuhën shqipe në lokale private. U zgjodhën edhe organet drejtuese të tij. Veprimtaria arsimore u organizua në 14 fakultete dhe 7 shkolla të larta. Në vitin akademik 1991/92 studimet i vijuan 19,622 studentë (15,826 të rregullt dhe 3,796 me korrespondencë). Numri i tyre gjatë viteve në vijim shkoi duke u zvogëluar. Aso kohe në këtë institucion punonin 845 mësimdhënës dhe bashkëpunëtorë të rregullt dhe 247 në punë plotësuese. Ndonëse në kushte shumë të vështira, në Universitetin e Prishtinës iu kushtua vëmendje e veçantë punës mësimore, botimit të teksteve universitare në gjuhën shqipe etj. Universiteti bëri marrëveshje me disa universitete të vendeve të ndryshme. Mësimdhënësit e tij dhanë kontribut të çmuar për ngritjen dhe punën e Universitetit të Tetovës, themeluar më 1994. U bënë përpjekje, gjithashtu, për ringjalljen e veprimtarisë studentore, kryesisht nëpërmjet Unionit të Pavarur të Studentëve. Në kushte të jashtëzakonshme, Universiteti i Prishtinës punoi deri më 21 mars 1999, kur e ndërpreu punën përkohësisht, për shkak të luftës. Gjatë luftës së viteve 1998-1999 u vranë 322 studentë dhe 8 mësimdhënës të këtij Universiteti. Universiteti i Prishtinës rifilloi punën në objektet legale më 2 gusht 1999, në Kosovën e çliruar. Në vitin akademik 1999/2000 filloi edhe reforma e gjithanshme në frymën e Deklaratës së Bolonjës, e cila ligjësohet me Ligjin mbi arsimin e lartë në Kosovë (2003). Sipas modelit evropian të studimeve, Universiteti i Prishtinës filloi të punojë në vitin akademik 2001/02. Më 15 korrik 2004 Kuvendi i Kosovës miratoi edhe Statutin e Universitetit të Prishtinës. Krahas reformës u bënë përpjekje edhe për përmirësimin e infrastrukturës mësimore dhe administrative. Universiteti i Prishtinës, i reformuar, ka 17 fakultete: Fakultetin Filozofik, Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore, Fakultetin e Filologjisë, Fakultetin Juridik, Fakultetin Ekonomik, Fakultetin e Ndërtim-

tarisë dhe Arkitekturës, Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike, Fakultetin e Mjekësisë, Fakultetin e Arteve, Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë, Fakultetin e Gjeoshkencës dhe Teknologjisë në Mitrovicë, Fakultetin e Shkencave Sportive, Fakultetin e Edukimit, Fakultetin e Shkencave të Aplikuara të Biznesit në Pejë, Fakultetin e Shkencave Teknike të Aplikuara në Mitrovicë, Fakultetin e Shkencave Teknike të Aplikuara në Ferizaj. Universiteti i Prishtinës bashkëpunon me shumë universitete dhe institucione të tjera në vende të ndryshme. Është anëtar i shumë asociacioneve ndërkombëtare. (Hajrullah Koliqi)

UNIVERSITETI I PRIZRENIT. Universiteti publik "Ukshin Hoti" në Prizren u themelua në vitin 2010. Në përbërjen e tij janë këto fakultete dhe programe studimore: Fakulteti Ekonomik



UNIVERSITETI I PRIZRENIT

me drejtimet administrim biznesi dhe menaxhim ndërkombëtar; Fakulteti Juridik; Fakulteti i Shkencave Kompjuterike me drejtimet dizajni i softuerit dhe teknologji e informacionit dhe telekomunikimit; Fakulteti i Edukimit me programet mësimi fillor dhe parashkollor; Fakulteti i Filologjisë me programet gjuhë e letërsi shqipe, gjuhë angleze dhe gjuhë gjermane. Universiteti ofron studime për ciklin baçelor dhe master. (Vlora Sylaj)

UNIVERSITETI I TETOVËS. Institucion i arsimit të lartë në Maqedoni. U themelua më 17 dhjetor 1994, si Universiteti i Tetovës, sipas modelit të Universitetit të Prishtinës. Themelimi i tij u realizua me nismën dhe angazhimin e intelektualëve, veprimtarëve dhe liderëve politikë shqiptarë nga Maqedonia, të



UNIVERSITETI I TETOVËS

kryesuar nga prof. dr. Fadil Sylejmani. Universiteti i Tetovës në fillim e zhvilloi veprimtarinë në kushte të jashtëzakonshme, sepse autoritetet shtetërore maqedonase u angazhuan me të gjitha mjetet kundër themelimit dhe veprimtarisë së tij. Ligjëratat e para në këtë universitet u mbajtën më 16-17 shkurt 1995 në Poroj dhe në Reçicë të Vogël. Universitetin e Tetovës e mbajti vetë populli shqiptar i Maqedonisë dhe diaspora shqiptare. Kontribut të veçantë në veprimtarinë arsimore-shkencore të tij dhanë edhe mësimdhënësit e Universitetit të Prishtinës. Pas shumë përpjekjeve dhe sakrificave të mëdha, sidomos me nënshkrimin e Marrëveshjes së Ohrit (2001), autoritetet shtetërore maqedonase më 20 shkurt 2004 pranuan ta legalizojnë veprimtarinë e këtij universiteti me emrin Universiteti Shtetëror i Tetovës. Ky universitet përbëhet prej këtyre fakulteteve: ekonomik, juridik, të shkencave aplikative, të arteve të bukura, filozofik, të filologjisë, të mjekësisë, të shkencave matematike-natyrore, të teknologjisë së ushqimit, të edukimit fizik, të biznesit dhe të administrimit. Mësimi zhvillohet kryesisht në gjuhën shqipe, por edhe në atë maqedonase dhe angleze. Viteve të fundit në këtë Universitet u punua për krijimin e kushteve materiale dhe për ngritjen e cilësisë së studimeve, sidomos për formimin e kuadrit të kualifikuar. (Myqereme Rusi)

UNIVERSITETI VEROR NDËRKOMBËTAR I PRISHTINËS (UVNP). Formë e arsimimit, komunikimit dhe bashkëpunimit të studentëve dhe mësimdhënësve të Universitetit të Prishtinës me studentë dhe mësimdhënës të qendrave të tjera universitare, e cila funksionon në kuadër të këtij universiteti. Filloi në vitin 2001 me emrin Universiteti Veror i Prishtinës.

UVNP-ja e realizon veprimtarinë e vet çdo vit gjatë muajve të verës (korrik ose gusht). Atë e financojnë donatorë të ndryshëm: të huaj dhe vendorë. Organizon kurse dy-tri javore nga fusha të ndryshme, me studentë nga vende të ndryshme dhe me mësimdhënës vendorë dhe të huaj (bashkëmësimdhënie). Fillimisht mësimi është zhvilluar në gjuhën shqipe dhe në atë angleze, ndërsa viteve të fundit vetëm në gjuhën angleze. Për pjesëmarrësit, krahas mësimit, organizohen edhe programe shoqërore, ekskursionet, tubime, aktivitete kulturore etj. Në fund pjesëmarrësit marrin certifikata sipas sistemit të ECTS. (Naser Zabeli)

UOKER Uilliam (William Walker) (1935-).

Lindi në Kearny, Nju-Xhersi, SHBA. Ishte diplomat i Departamentit Amerikan të Shtetit në Amerikën Latine. Në periudhën 1985-1988



UILLIAM UOKER

shërbeu në administratën e lartë amerikane, ndërsa nga viti 1994 deri më 1997 ishte zëvendës-president i Universitetit për Mbrojtje Kombëtare në Uashington D.C. Në gusht të vitit 1997 u emërua Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm dhe i Administratës kalimtare të Kombeve të Bashkuara për Sllavoninë Lindore, Baranjen dhe Sirmiumin Perëndimor. Gjatë luftës në Kosovë, më 1998 U. Uoker u emërua shef i Misionit Verifikues i OSBE-së në Kosovë dhe kishte për detyrë verifikimin e zbatimit të "Marrëveshjes së tetorit" për t'i dhënë fund krimeve në Kosovë, tërheqjen e forcave të armatosura dhe vendosjen e një armëpushimi. U. Uoker gjatë periudhës tetor 1998 - qershor 1999 pasqyroi drejt para shteteve perëndimore situatën në terren. Pas krimit të 15 janarit mbi popullsinë civile në fshatin Reçak afër Shtimjes, ku ishin masakruar 45 civilë të paarmatosur, një ditë më vonë U. Uoker vizitoi fshatin dhe deklaroi para gazetarëve: "Nga ajo që pashë, nuk ngurroj ta përshkruaj ndodhinë si masakër dhe krim kundër njerëzimit". Kjo deklaratë e shefit të misionit të OSBE-së u transmetua në mediet më të rëndësishme botërore dhe shënoi fillimin e ndërhyrjes së forcave të NATO-s në Kosovë. Misioni i U. Uokerit në Kosovë njihet si njëri ndër misionet më të suksesshme të

OSBE-së. Në Kosovë dhe në Shqipëri U. Uoker u ndërta me shumë mirënjohje dhe dekorata. (Daut Bislimi)

URAT E PERIUdhËS OSMANE. Urat më të vjetra të ndërtuara në Kosovë gjatë periudhës osmane datojnë nga mesi i shek. XV, ndërsa urat më të mira u ndërtuan shekujve XV-XVI. Njëra nga urat më monumentale të kësaj periudhe është Ura e Gurit mbi lumin Vardar në Shkup, me 14 harqe, e ndërtuar në shek. XV. Në këtë kohë u ndërtua ura e Mahmud Pashës, (e njohur edhe si Ura e Vojinoviqit) në perëndim të qytetit Vushtrri, mbi lumin Sitnicë, me 9 harqe, e gjatë 140 m dhe e gjerë 5 m. Gjatë kësaj kohe u ndërtua edhe ura e fshatit Budisalc, afër Pejës, mbi lumin Istog, me gjatësi 83 m dhe gjerësi 4.72 m. Në Prizren, mbi lumin Bistricë, në fillim të shek. XVI janë ndërtuar tri ura: Ura e Suzit (e ndërtoi poeti prizrenas Suzi Prizreni), pranë xhamisë së tij, ndërmjet viteve 1510-1513; Ura e Suxhudit (e ndërtoi poeti tjetër prizrenas, Suxhudi, para vitit 1520); Ura e Gurit me tri harqe (e ndërtoi i ati i Koxha Sinan Pashës, Ali Beu nga fshati Topojan, në vitin 1533. Ura e dyzet puseve (kërk-bunar), gjashtë kilometra larg Prizrenit, u ndërtua në shek. XVIII. Ura e Gurit me tri harqe, në qendër të Pejës, mbi lumin Bistricë, e cila lidhte Pejën me rrugën e Gjakovës, u ndërtua në shek. XVI (u rrënuar në vitet pesëdhjetë të shek. XX). Hasan Pashë Jemishqiu në vitin 1589 ndërtoi urën mbi lumin Drini i Bardhë, në Rogovë, nga e cila kanë mbetur pjesë të bazamentit të qemerëve të saj dhe mbishkrimi. Mehmet Pashë Kaçaniku në vitin 1600 ndërtoi urën mbi lumin e Nerodimes, në Kaçanik. Mbi lumin Krena në Gjakovë janë ndërtuar disa ura, prej të cilave kanë mbetur Ura e Islam Beut, me katër harqe, e ndërtuar në shek. XVIII dhe Ura e Taliqit, pranë çezmës së Panxhallës, e ndërtuar në shek. XVIII. Në Tetovë, mbi lumin Radika janë ndërtuar katër ura guri, të cilat kanë lidhur pjesën jugore me pjesën veriore të qytezës së atëhershme (Kallkandelen): Ura e Topit (Top-qypri) te Çarshia e Epërme, e ndërtuar nga Hasan Pashë Tetova në gjysmën e dytë të shek. XVIII; Ura e Kazazëve, e ndërtuar nga i biri i Hasan Pashës, Rexhep Pasha, në fund të shek. XVIII; Ura pranë Xhamisë së Pashës, e ndërtuar nga i biri i Rexhep Pasha, Abdurrahman Pashë Tetova në vitin 1921.

Disa ura me vlera arkitektonike u ndërtuan nga shoqëritë e fuqishme esnafore të vendit

në shek. XVIII. Ura e Terzive në kilometrin e dhjetë të rrugës Gjakovë-Prizren, mbi lumin Erenik, u ndërtua nga esnafi i terzinjve të Gjakovës në vitin 1796 (e gjatë 221 m dhe e gjerë 5 m), pastaj Ura e Tabakëve, në skaj të qytetit të Gjakovës, mbi lumin Erenik u ndërtua nga esnafi i tabakëve të Gjakovës në shek. XVIII (e gjatë 128.50 m). Ura e Tabakëve dhe Ura e Terzive janë ndërtuar me teknikën e Urës së Mesit në Shkodër.

Shumica e urave të ndërtuara në periudhën osmane, janë rrënuar nga vërshimet e kohëpas-kohshme dhe në vend të tyre janë ndërtuar ura të reja. Kështu, pas vërshimit të Lumbardhit në Prizren në vitin 1806, u rrënuar ura që quhej Rahlinit, ndërkaq ura tjetër që u ndërtua në vend të saj u quajt Ura e Marashit. Gjithashtu edhe ura e Arastës, e cila lidhte Çarshinë Arasta me Xhaminë e Sinan Pashës, pas rindërtimit mori emrin Ura e Re. Ura e Ibrit në Mitrovicë e ndërtuar në vitin 1884, pas rrënimit në vitin 1977, nuk e ruajti pamjen origjinale. Urën në fshatin Bubël të Malishevës, mbi lumin Mirushë e ndërtoi tregtari gjakovar, Hamza Sami Këpuska, në vitin 1883. Kjo urë me tre qemerë edhe sot qëndron e rinovuar. Nga periudha osmane kanë ngelur edhe disa ura prej druri, si Ura e Zallit në Pejë, e cila lidhte qendrën e qytetit me lagjen Kapeshnica, Ura e Gegajve (Gegiqëve), po ashtu në Pejë etj. (Nehat Krasniqi)

URAT E VJETRA (shek. XV-XIX). Janë ndërtime utilitare publike, që ruhen ende në shumë vendbanime të Kosovës. Ato ende ruajnë originalitetin, ndonëse dëmtimet në



URA E TERZIVE

këto objekte janë të mëdha dhe shkatërrimi i kërcënon dita-ditës. Në Kosovë gjenden disa

ura të vjetra prej guri, nga të cilat më të njohurat janë: Ura e Vjetër e Gurit në Vushtrri (shek. XV, tani në të thatë), Ura e Vjetër e Gurit në Pejë (shek. XV, tani rrënojë), Ura e Vjetër e Gurit në Prizren (shek. XV), Ura e Vjetër e Gurit në Zallç të Klinës (shek. XV), Ura e Tabakëve, Ura e Terzinjve dhe Ura e Taliqit në Gjakovë (shek. XVIII), Ura e Vjetër e Gurit në Bubël të Malishevës (shek. XVIII), Ura e Vjetër e Gurit në Klinë (shek. XIX) etj. Objektet janë ndërtuar kryesisht në shek. XV-XIX, por ka indikacione materiale se disa syresh janë ngritur në themelet e urave më të vjetra të periudhës antike, nga koha e sundimit romak-bizantin në veçanti. Veprat u ndërtuan nga mjeshtër vendas të traditës, që kishin përvojë dhe përvetësuan mjeshtërinë e ndërtimit të urave monumentale. Këto ura veçoheshin si në aspektin konstruktiv, ashtu edhe në atë funksional e artistik. Ato që lidhin dy anë të brigjeve të lumenjve janë të ndërtuara me tre ose me më shumë harqe. Urat e vjetra kanë gjatësi të ndryshme, prej 3 m (ura e vjetër në Vernicë të Vushtrrisë) deri në 193 m (Ura e Terzinjve në Gjakovë), ndërsa gjerësia shkon nga 3.50 deri në 4.80 m. Edhe për nga numri i harqeve, ato janë të ndryshme: nga ura me një gjysmëhark në Vernicë, e deri në trembëdhjetë gjysmëharqe në Zallç të Klinës. Në disa nga këto ura nuk vërehen gjysmëharqet, meqë janë të mbuluara. Ballinat e gjysmëharqeve përherë dalin paksa nga muret konstruktive dhe të realizuara më gurë kuadratikë të përpunuar. Në të shumtën e rasteve, harqet janë simetrike në raport me harkun qendror. Në këto ndërtime paraqiten edhe hapjet ose dritaret e tyre lehtësuese. Kemi raste kur në ballinat e harqeve të urave paraqitet plastika gurore e realizuar në teknikën e plastikës së imët. Në relieve ka elemente gjeometrike, armë, motive alegorike etj. Dekorimet kanë edhe simbolikën e tyre. Urat si vepra të karakterit publik utilitar, edhe pse sot nuk luajnë rolin e tyre të kohës së ndërtimit, ende janë atraktive dhe në shumë raste i përshtaten ambientit ku janë ndërtuar dhe shquhen për monumentalitetin e tyre. (Fejz Drançolli)

URBANIZIMI. Është fenomeni i rritjes natyrore dhe mekanike të popullsisë në hapësirat urbane, zgjerimi i këtyre zonave dhe transformimi i fshatrave në qytete. Kosova si vend i pazhvilluar deri pas Luftës së Dytë Botërore kishte të gjitha karakteristikat e një hapësire rurale. Në qendrat e vogla urbane të asaj peri-

udhe jetonte numër i vogël i popullsisë. Më vonë, pas viteve '70 të shekullit të kaluar, pati një rritje të vazhdueshme të popullsisë urbane në Kosovë. Rritja më e madhe e popullsisë urbane është shënuar pas përfundimit të luftës së fundit të vitit 1999. Në rritjen e popullsisë urbane në Kosovë ka ndikuar kryesisht migrimi i popullsisë fshat-qytet. Aktualisht në Kosovë ekzistojnë vetëm disa qendra urbane me karakter polifunksional dhe hapësirë të konsiderueshme gravituese. Si të tilla ato arrijnë të absorbojnë numër më të madh të popullsisë nga rrethina rurale. Këto janë: Prishtina, Prizreni, Peja, Gjakova, Mitrovica, Ferizaj dhe Gjilani. Numri i popullsisë që jeton në hapësirat urbane të Kosovës, sipas regjistrimit të vitit 2011 është 661,586 banorë, apo rreth 38% të popullsisë së përgjithshme. (Hazer Dana)

UROSHEVIQ (Urošević) Atanasije (1898-1992). Lindi në Gjilan, ku e mbaroi shkollën fillore. Gjimnazin dhe Fakultetin Filozofik e kreu në Shkup, ku më pas mbrojti tezën e disertacionit për Moravën e Epërme. Punoi në Universitetin e Beogradit dhe pastaj ligjëroi në Fakultetin Filozofik të Shkupit. Pas pensionimit u angazhua profesor dhe shef i katedrës së gjeografisë në Fakultetin Filozofik të Prishtinës, të cilën e udhëhoqi deri në vitin 1968. Botoi shumë punime dhe libra për krahina dhe vendbanime të ndryshme të Kosovës, kryesisht të tipit urban. Duke ndjekur metodologjinë e hulumtimit të shkollës antropogjeografike të Cvijiqit dhe duke qenë i thhtar i tezave të tij, A. Urosheviq bëri vlerësime tendencioze dhe raciste për shqiptarët: u mohoi atyre të drejtat historike dhe i quajti “të vrazhdë, kokëfortë, gjakpirës dhe kusarë, të prirë për dhunë ndaj serbëve” etj. Shkruante se shqiptarët e Kosovës nuk janë shqiptarë të vërtetë, por vetëm serbë të islamizuar. Mbështeti teza antishkencore edhe lidhur me migrimet e popullsisë, duke shkruar në çdo publikim të tij se shqiptarët kanë ardhur në Kosovë dhe viset përreth nga territoret malore të Shqipërisë Veriore, duke mbushur një “vakum demografik” dhe duke “islamizuar dhe shqiptarizuar” në përmasa të mëdha serbët e mbetur. (Hivzi Islami)

USTAIBO Muhamet (1947-) Gazetar. Lindi në Prizren. Shkollimin fillor e kreu në Prizren, të mesmin në Prishtinë. Studimet për gjuhë dhe letërsi turke i kreu në Universitetin e

Prishtinës. Në fillim punoi gazetar në Radio Prishtinë, më pas u bë kryeredaktor dhe udhëheqës i programit në gjuhën turke. Botoi shumë shkrime në gazetën turke “Birlik” të Maqedonisë. Ishte njëri ndër themeluesit e parë të shoqatës “Gerçek” në Prishtinë. Jeton në Turqi. (Agnesa Rashiti-Glloboderi)

USHAKU Ruzhdi (1938-). Gjuhëtar, profesor universiteti. Lindi në Ulqin. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, normalen në Prishtinë. Studimet për letërsisë frënge dhe gjuhësi latine



RUZHDI USHAKU

i përfundoi në Sarajevë (1964). Në Paris më 1962/63 kreu shkollën e pestë të studimeve moderne frënge me “Diplôme Supérieur d’Études Françaises Modernes”. Studimet pasuniversitare i kreu në Beograd, ku mbrojti edhe tezën e disertacionit të doktoratës (1979). Nga viti 1971 punoi mësimdhënës, e më vonë profesor i gjuhës frënge dhe i latinishtes në Fakultetin Filozofik në Prishtinë. Kreu edhe detyra në institucionet e shkollimit të lartë, përfshirë edhe kryetar i Këshillit Mësimor Shkencor të Universitetit të Prishtinës. Është autor i shumë librave nga fusha e filologjisë: “Kërkime filologjike” (1981), “Fjalitë hipotetike me SI në gjuhën bashkëkohore frënge të teksteve letrare” (1983), “Paralele të ligjërimit poetik” (1986), “Ulqini në gjurmë të shekujve” (1991), “Hulumtime etnolinguistike” (2000), “Ndihmesa onomatologjike nga hapësira iliroarbërore” (2006), “Ulqini nga dritaret e kohës” (bashkautor, 2006), “Ulqini në përmasa kërkimi dhe frymëzimi” (2010) etj. Botoi studime, ese dhe artikuj nga fusha të ndryshme të gjuhësisë. (Bahri Koskoviku)

USHTRIA ÇLIRIMTARE E KOSOVËS (UÇK). Organizim politik e ushtarak i popullit shqiptar në Kosovë, me synim çlirimin nga sundimi i Serbisë dhe ish-Jugosllavisë. Fillimet e UÇK-së gjenden në lëvizjen ilegale, e cila veproi në Kosovë që nga Lufta e Dytë Botërore, por mori përmasa të lëvizjes gjithëpopullore në vitet ’80 dhe ’90 të shekullit të kaluar. Në vitet 1981-1990 të gjitha organizatat ilegale, me orientime të ndryshme ideologjike, do të bashkohen në Lëvizjen



USHTRIA ÇLIRIMTARE E KOSOVËS (UÇK)

Popullore për Republikën e Kosovës (LPRK) e cila më pas (në vitet ’90) do të riemërtohet Lëvizja Popullore e Kosovës (LPK) dhe në Lëvizjen Kombëtare për Çlirim të Kosovës (LKÇK). Rol të rëndësishëm politik dhe mobilizues në krijimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) kishte pikërisht LPK-ja. Në fillimet e saj UÇK-ja gjithë veprimtarinë e saj ushtarake e zhvilloi në forma të luftës guerile. Aksionet e para të armatosura, për të cilët më vonë UÇK-ja do të marrë përgjegjësinë përmes komunikatave, ishin aksione kundër forcave policore serbe: i pari u krye në shtator të vitit 1992, në stacionin e autobusëve në Drenas, ndërsa i dyti në natën e 23-24 majit 1993 në udhëkryqin me hekurudhë po në Drenas. Adem Jashari ishte bashkërenduesi i të gjitha aksioneve guerile në mbarë Kosovën. Më 5 prill 1993 në kullën e Jasharëve në Prekaz të Ulët u mbajt një takim për zhvillimin e mëtejshëm të luftës çlirimtare. Në këtë takim, ku përveç gueriles ishin ftuar edhe veprimtarë politikë, u mor vendimi për formimin e një organizimi të ri politik dhe ushtarak, të cilin Adem Jashari e quante Ushtria e Kosovës. Në këtë takim Adem Jashari u emërua komandant i përgjithshëm i formacionit ushtarak, i cili më vonë u quajt Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK). Ndërkaq, vendimi për formimin e krahut ushtarak në kuadër të LPK-së u mor në mbledhjen e këshillave të rretheve dhe të degëve jashtë vendit, të mbajtur në Kërçovë në mars të vitin 1993.

Si formacion ushtarak, UÇK-ja doli hapur më 28 nëntor 1997, me rastin e varrimit të mësuesit nga Llausha, Halit Geci, i vrarë nga policia serbe. Me këtë rast, në ceremoninë e varrimit u paraqitën tre luftëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës: Rexhep Selimi, Mujë Krasniqi dhe

Daut Haradinaj. Pas këtij veprimi, UÇK-ja e shtriu aktivitetin e saj në tërë Kosovën. Në anën tjetër, Serbia ndërmoi masa të ashpra represive kundër çdo lloj rezistence. Natën e 21 e 22 janarit 1998, forcat policore dhe ushtarake të Serbisë ndërmorën një aksion ndëshkues mbi familjen Jashari, por nuk arritën të thyenin rezistencën. Pas aksionit të UÇK-së në Likoshan më 28 shkurt 1998, ku u vranë 4 policë serbë e më pas u vranë dhe u masakruan 24 shqiptarë të paarmatosur, ushtria dhe policia e Serbisë, më 5, 6 e 7 mars 1998 ndërmori aksionin për likuidimin e komandantit të UÇK-së, Adem Jasharit. Në këtë aksion u vranë 22 anëtarët e ngushtë të familjes Jashari dhe 34 bashkëfshatarë të tjerë të moshave të ndryshme të Jasharëve të Prekazit. Pas kësaj ngjarjeje, filloi masivizimi dhe organizimi i ri operativ, politik dhe ushtarak i UÇK-së. Sukseset në terren të UÇK-së tërhoqën edhe vëmendjen e faktorit ndërkombëtar, veçmas të SHBA-së dhe të Bashkimit Europian. Kontaktet më përfaqësues të UÇK-së i filloi diplomati amerikan Riçard Hollbruk, në Junik, në qershor të vitit 1998, ndërsa më pas, në korrik të atij viti, zhvilluan takime Jan Kikerti dhe Dejvid Sllin në Kleçkë. Më pas takimet diplomatike u intensifikuan nga ambasadori i SHBA-së në Shkup, Kristofer Hill, pastaj Lari Rosin, dhe ambasadori i BE-së, Volgan Petritç. Takimet u mbajtën në zonat e lira të luftës, si në Dragobil, Lladrovç e Drenoc të Vllahve të Malishevës dhe Likoc të Drenicës. Legjitimitimin ndërkombëtar UÇK-ja e shënoi sidomos me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të saj në Konferencën e Rambujesë (shkurt-mars 1999).

Faza vijuese, dhjetor 1998-qershor 1999, shënoi konsolidimin dhe riorganizimin e UÇK-së, pas humbjeve që kishte pasur ajo në ofensivën e gushtit dhe të shtatorit 1998. Riorganizimin e filloi Ilaz Kodra, komandant i Brigadës 113 “Fehmi Lladrofc” në Zonën Operative (ZO) të Drenicës. Riorganizimi u zyrtarizua nga Shtabi Përgjithshëm (SHP) i UÇK-së në mbledhjen e mbajtur nga 12-18 nëntorit 1998, në fshatin Lladrofc të Malishevës. Drejtoria politike ishte konsoliduar më herët. Ajo ishte bartëse e qëndrimeve politike të UÇK-së dhe mbante përgjegjësinë për komunikim me delegacionet e brendshme dhe të jashtme. Që më parë Adem Demaçi ishte ngarkuar si përfaqësues politik i UÇK-së për bisedime me gjithë spektrin politik shqiptar. Sipas strukturimit të ri, në

SHP shumica e anëtarëve të Drejtorisë Politike do të merrnin edhe përgjegjësi ushtarake. Në atë mbledhje u mor vendimi që kufijtë politikë dhe administrativë të Kosovës të ishin hapësira e operimeve të UÇK-së. U caktuan dhe u emëruan edhe zonat operative: Zona Operative e Drenicës, nr. 1; Zona Operative e Pashtrikut, nr. 2; Zona Operative e Dukagjinit, nr. 3; Zona Operative e Shalës, nr. 4; Zona Operative e Llapit, nr. 5; Zona Operative e Nerodimes, nr. 6; dhe Zona Operative e Karadakut, nr. 7. Edhe gjatë bombardimeve të NATO-s kundër caqeve ushtarake serbe, zona më vitale dhe e mbrojtur e luftës ishin malet e Berishës, ku ishte i vendosur SHP i UÇK-së, Radio “Kosova e lirë”, Agjencia e lajmeve “Kosovapresse” etj. Gjatë 78 ditëve të bombardimeve të NATO-s kishte një bashkëpunim të koordinuar në mes të Aleancës dhe UÇK-së. Më 12 qershor 1999 forcat e NATO-s hyjnë në Kosovë, ndërsa më 22 qershor 1999 u nënshkrua marrëveshja për demilitarizimin dhe transformimin e UÇK-së, ndërmjet komandantit të KFOR-it, gjeneralit M. Xheksion dhe kryeministrit të Qeverisë së Përkohshme të Kosovës, H. Thaçit. (Jakup Krasniqi)

USHTRIA ÇLIRIMTARE KOMBËTARE (UÇK). Forcë politike dhe ushtarake e shqiptarëve në Maqedoninë Veriore dhe Perëndimore. Lindi si rezultat i mohimit të vazhdueshëm të të drejtave kombëtare të popullsisë shqiptare në Maqedoni. Kryengritja e armatosur e shqiptarëve kundër padrejtësive të pushtetit maqedonas filloi më 15 shkurt 2001 në Tanushë të Shkupit. Më 6 janar 2001 togu në zhvillim, i përbërë nga ushtarë nga Maqedonia pjesëtarë të UÇK-së së Kosovës, u vendos në Tanushë. Nga fundi i shkurtit kaluan në fshatin Malinë. Këta ushtarë vepronin në kuadër të Brigadës 113 “Ismet Jashari-Kumanova”. Komandat i saj më 5 mars u emërua Fadil Nimani-Tigri. Më 14 mars një kompani ushtarësh e UÇK-së filloi veprimet luftarake në Kalanë e Tetovës. Komandant i Përgjithshëm dhe përfaqësues politik i UÇK-së ishte Ali Ahmeti, ndërsa shef i Shtabit të Përgjithshëm gjeneralmajor Gëzim Ostreni. Në mars të vitit 2001 u themelua Fondi “Liria Kombëtare”, me qendër në Zvicër, i cili kishte për detyrë të mbledhte ndihma financiare për luftën. Musa Xhaferi u emërua koordinator i fundit. Në kuadër të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare

vepruan Brigada 113 "Ismet Jashari-Kumano-va", në zonën e Kumanovës, me komandant Fadil Nimanin-Tigri dhe, pas rënies së tij, komandant u emërua Sami Ukshini-Sokoli. Brigada 114 "Fadil Nimani-Tigri" vepronte në zonën e Shkupit, me komandant Nazim Bushin, ndërsa Brigada 115 vepronte në zonën e Radushës (pjesa veri-perëndimore e Shkupit), me komandant Rafis Aliti-Mësuesi. Brigada 112 "Mujdin Aliu" vepronte në zonën e Tetovës, me komandant Hazbi Lika-Qela, pastaj Isa Lika-Iliri. Brigada 116 vepronte në zonën e Gostivarit dhe të Dibrës, me komandant Tahir Sinanin dhe, pas rënies së tij, me komandant Talat Xhaferin. Komanda e kësaj brigade ishte e vendosur në fshatin Tanushë të Gostivarit. Brigada 111 "Beqir Limani" në formim parashihej të vepronte në zonën e Kërçovës, Strugës, Ohrit, Prilepit dhe Manastirit. Më 9 mars 2001 Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së shpalli komunikatën nr. 6, e cila më vonë shërbeu si bazë për Marrëveshjen e Prizrenit dhe Marrëveshjen e Ohrit. Ajo shpallte se UÇK-ja ishte për ruajtjen e integritetit territorial të Maqedonisë, por kërkonte ndërmjetësim ndërkombëtar për zgjidhjen e konfliktit. Njëkohësisht kërkohej që t'i jepej fund diskriminimit të shqiptarëve. Më 20/21 mars 2001 Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së nga Bresana e Prizrenit kaloi në Vicë të Tetovës, pastaj në Sellcë dhe, në prill, në Shipkovicë, ku qëndroi deri në fund të luftës. Gjatë kësaj periudhe UÇK-ja arriti të hapë front në gjatësi prej 100 km, fitoi mbështetje të plotë nga bashkëkombësit, rriti forcën e saj ushtarake dhe sensibilizoi opinionin ndërkombëtar për gjendjen e shqiptarëve në Maqedoni. Më 24 prill përfaqësuesi politik i UÇK-së Ali Ahmeti, i dërgoi memorandum Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-së, kryetarit të Komisionit European dhe kryesuesit të OSBE-së, përmes të cilit qartësoheshin synimet dhe qëndrimet e UÇK-së për të ardhmen e Maqedonisë, si dhe shprehej për përfshirjen e komunitetit ndërkombëtar për zgjidhjen e konfliktit. Si rrjedhojë, më 22 maj u arrit Marrëveshja e Prizrenit midis përfaqësuesit politik të UÇK-së Ali Ahmetit dhe dy liderëve të partive politike shqiptare, Arbën Xhaferit të PDSH-së dhe Imer Imerit të PPD-së, me të cilën faktori politik dhe ushtarak i shqiptarëve të Maqedonisë unifikonin qëndrimet. Me këtë Marrëveshje u saktësuan kërkesat e faktorit shqiptar, siç ishte ruajtja e integritetit

dhe e karakterit multietnik të Maqedonisë, zyrtarizimi i gjuhës shqipe, përfaqësimi pjesëtimor etnik në organet shtetërore, zgjerimi i kompetencave për pushtetin komunal, vendosja e demokracisë konsensuale për çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat kombëtare (pamundësimi i mbivotimit), rehabilitimi dhe risocializimi i plotë i gjithë pjesëtarëve të UÇK-së, rindërtimi i fshatrave dhe ekonomive familjare të shkatërruara gjatë luftimeve etj. Gjithashtu kërkohej angazhimi i SHBA-së dhe BE-së për zgjidhjen e krizës. Disa ditë më vonë, më 5 korrik u nënshkrua marrëveshja për armëpushim të përhershëm, por ajo nuk u respektua. U rivendos përsëri në fund të korrikut. Ndërkohë, më 8 gusht 2001 përfunduan negociatat shqiptaro-maqedonase për nënshkrimin e Marrëveshjes Kornizë (Marrëveshja e Ohrit). Më 13 gusht marrëveshja u nënshkrua zyrtarisht në Shkup nga presidenti i Maqedonisë, Boris Trajkovski, dhe liderët e partive politike: të VMRO DPMNE-së Lubço Georgievski (njëkohësisht kryeministër), të LSDM-së Branko Cërvenkovski, i PDSH-së Arbën Xhaferi dhe i PPD-së Imer Imeri. Dokumenti u nënshkrua edhe nga përfaqësuesi i BE-së, Fransua Leotar dhe ai i SHBA-së, Xhejms Perdju (James Pardew). Marrëveshja parashikonte ndryshimin e kushtetutës dhe avancimin e të drejtave të shqiptarëve. Pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Ohrit, më 14 gusht në Shipkovicë të Tetovës, u nënshkrua marrëveshja për demilitarizimin e UÇK-së midis përfaqësuesit politik të UÇK-së, Ali Ahmetit dhe përfaqësuesit të NATO-së, Piter Fejt. (Fehari Ramadani)

USHTRIA ÇLIRIMTARE PËR PRESHEVË, MEDVEGJË DHE BUJANOC (UÇPMB).

Forcë e armatosur dhe e organizuar e popullit shqiptar të Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit (Luginës së Preshevës). U themelua si kundërpërgjigje ndaj dhunës sistematike të ushtruar nga Serbia, për mbrojtje dhe vetëmbrojtje. Doli publikisht më më 26 janar 2000, në fshatin Dobrosin, në ditën e varrimit të vëllezërve Isa e Shaip Saqipi, të vrarë nga forcat serbe. Më 24 mars dhe 14 prill të vitit 2000 në Gjilan u mbajt takimi mes liderëve politikë të kësaj ane: Shefket Musliut, Halil Selimit, Jonuz Musliut, Shaqir Shaqirit; liderëve të Partisë Demokratike të Kosovës: Hashim Thaçit, Jakup Krasniqit, Fatmir Limajt, Bilall

Sherifit dhe të përfaqësuesve të KFOR-it e të UNMIK-ut. Në atë takim u arrit marrëveshje për formimin e Këshillit Politik për Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc. Mirëpo synimi i forcave serbe për t'u futur në vendbanimet shqiptare, për të ushtruar dhunë dhe për të shpërngulur shqiptarët provokoi edhe incidentet e armatosura. Njësitet ushtarake të UÇPMB-së iu kundërpërgjigjen këtyre incidenteve dhe e shtrinë aktivitetin ushtarak në tërë brezin kufitar që ndante Luginën e Preshevës me Kosovën. UÇPMB-ja u konsolidua në dhjetor të vitit 2000: komandant i Shtabit të Përgjithshëm u emërua Shefket Musliu, zëvendëskomandant - Mustafë Shaqiri dhe shef i Shtabit - Muhamet Xhemalji. UÇPMB-ja vepronte në tri zona: Në veriperëndim të Luginës së Preshevës shtrihej Zona Operative e Qarrit dhe brenda kësaj zone vepronte Brigada 114 "Agim Elshani". Në perëndim të Luginës së Preshevës u formua Zona Operative e Bujanocit, brenda së cilës vepronin Brigada 111 "Fatmir Ibishi" dhe Brigada 112 "Sherif Jonuzi dhe Enver Bajrami". Kjo zonë përfshinte territoret nga Breznica e Bujanoci deri në Bukoc të Preshevës. Në juglindje u formua Zona Operative e Preshevës, brenda së cilës vepronin dy brigada: Brigada 113 "Ibrahim Fejzullahu" dhe Brigada 115 "Karadaku". Brenda kësaj zone përfshiheshin territoret nga Bukoci i Preshevës deri në kufirin me Maqedoninë. Në fillim të vitit 2001 Qeveria e Republikës së Serbisë dhe Qeveria Federative formuan një këshill koordinues për Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë dhe në shkurt 2001 u bëri ftesë liderëve shqiptarë për bisedime. Këshilli Politik, Shtabi i Përgjithshëm si dhe përfaqësuesit e subjekteve politike në Preshevë kishin arritur marrëveshjen për formimin e grupit negociator që do të zhvillonte takimet me palën serbe. Më 12 mars 2001 në selinë e Shtabit të Përgjithshëm të UÇPMB-së në Konçul u arrit marrëveshja për armëpushim, e nënshkruar nga komandanti i Shtabit të Përgjithshëm të UÇPMB-së, Shefket Musliu. Më 23 mars 2001 në Merdare u zhvillua takimi i parë zyrtar mes palës serbe dhe asaj shqiptare, të ndërmjetësuar nga përfaqësuesit e bashkësisë ndërkombëtare. Më 20 maj 2001, me ndërmjetësim ndërkombëtar, udhëheqësit e UÇPMB-së nënshkruan "Deklaratën për demilitarizim". Me këtë akt mori fund lufta e armatosur. Një ditë para demilitarizimit të tërësishëm të UÇPMB-së, forcat jugosllave vra-

në kryenegociatorin e palës shqiptare, Ridvan Qazimin, (Komandant Lleshi). (Fehari Ramadani)

USHTRIA DARDANE. Sistem ushtarak me forca të organizuara. Kjo ishte një fuqi ushtarake kërcënuese për politikën pushtuese të Maqedonisë drejt veriut dhe të asaj romake më vonë. Falanga (njësia) kishte 8,000 ushtarë dhe modeli ishte marrë nga helenët. Ajo vepronte si tërësi dhe çdo ushtar kishte vend të caktuar. Ushtria përbëhej nga kalorësia e këmbësoria dhe ndahej në gjini të ndryshme, kryesisht në heshtarë, shigjetarë dhe shpatarë. Armët kryesore ishin shpata e harkuar njëteheshe (mahaira), shpata e shkurtër dhe e lakuar (sica), heshta e gjatë dhe e rëndë (sibyna), sëpata luftarake, si dhe thika llojesh të ndryshme. Ushtria dhe gjinitë kishin flamujt e tyre. Veshja e ushtarëve komandues ishte e ngjashme me ilirët e tjerë: përkrenarja ilire, mburoja, parzmorja (kardiofylaks) e kallçinjte (knemida).

Komandën mbi ushtrinë e kishte mbreti, i cili e udhëhiqte betejën. Kështu, mbreti dardan Longari ishte në krye të ushtrisë në betejën kundër mbretit të Maqedonisë, Demetrit II, si dhe kur u pushtua krahina e Orestidës dhe u arrit deri në fushat e Argestit në Maqedoni. Zhvillimi i ushtrisë dardane ishte i ngjashëm me ato të ushtrive të shteteve të tjera në fazat e hershme, me pjesëmarrjen e fshatarësisë në ushtri, e cila, në rast lufte, mbante armët dhe në kohë paqeje punonte tokën, si ajo e poliseve greke, maqedone dhe romake. Ushtria vepronte me radhë të dendur dhe në mënyrë të organizuar, duke përdorur taktika të ndryshme. Pjesën më të madhe të ushtrisë e përbënte këmbësoria e armatosur me armë të rënda. Lufta dhe tërheqja e ushtarëve bëhej në mënyrë të disiplinuar, pa i lëshuar radhët dhe pa i lënë të vdekurit dhe të plagosurit në fushëbetejë. Autori romak Livi shkruan: "... dardanët kthyen flamujt dhe u vendosën me radhë të rregullta përballë armikut, beteja u zhvillua njëlloj si në një luftë të vërtetë... U vranë pak, të plagosur pati më shumë, por asnjë nuk u zu, sepse në raste të rralla dalin nga radhët e tyre dhe të shtrënguar të gjithë së bashku luftojnë ose tërhiqen". Në ushtrinë dardane kishte ushtarë profesionistë me paga, mercenarë. Andaj etolët i kërkuan mercenarët dardanë në luftë kundër romakëve (190 p.e.r.),

mercenarët kalorës dardanë morën pjesë në luftërat qytetare romake, duke mbajtur anën e Pompeut (48 p.e.r.), pastaj në betejën e Farsalës etj. (Edi Shukriu)

USHTRIA E LIDHJES SHQIPTARE TË PRIZRENIT. Forca të armatosura, të formuara nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit për të mbrojtur tokat shqiptare që do të rrezikoheshin nga pretendimet e shteteve fqinjë. Si rregull i mobilizimit të forcave vullnetare për formimin e ushtrisë së Lidhjes ishte caktuar parimi “një burrë për shtëpi”. Ushtria e Lidhjes zbatonte urdhrat që dilnin nga udhëheqja më e lartë e saj. Komandant i forcave të Lidhjes ishte caktuar Sylejman Vokshi. Për të qenë më efikase, Lidhja kishte shpallur një besë të përgjithshme, sipas të cilës ndërpriteshin gjakmarrjet ndërmjet shqiptarëve. Ata që thyenin besën, do të përballeshin me forcën e ushtrisë së Lidhjes. Numri i vullnetarëve u shtua edhe më shumë, pas publikimit të vendimeve të Kongresit të Berlinit, me të cilët tokat shqiptare copëtoheshin dhe krahina të tëra do t’u jepeshin shteteve fqinje ballkanike. Forcat e Lidhjes u përballën edhe me forcat osmane, kur Porta e Lartë, nën presionin e Fuqive të Mëdha, u përpoq t’i dorëzonte Malit të Zi Plavën dhe Gucinë. Për këtë qëllim, në gusht të vitit 1878 ajo dërgoi mareshalin turk Mehmet Ali Pashë Maxharrin, për t’i bindur shqiptarët të mos i kundërshtonin vendimet e Berlinit. Forcat e armatosura të Lidhjes në Gjakovë zhvilluan një betejë të

ashpër, në të cilën fituan forcat shqiptare, duke shpartalluar repartet ushtarake osmane dhe duke lënë të vrarë edhe mareshalin turk. Më 11 janar 1879 patriotët shqiptarë organizuan në Prevezë një kuvend të jashtëzakonshëm, për të shprehur vendosmërinë e mbrojtjes së kufirit jugor dhe të krahinës shqiptare të Çamërisë. Kjo këmbëngulje e shqiptarëve dha rezultatet, sepse Greqia nuk mundi ta merrte Çamërinë. Nga ana tjetër, pasi nuk arriti të merrte Plavën dhe Gucinë, Mali i Zi kërkoi nga Fuqitë e Mëdha si kompensim Hotin, Grudën dhe Kelmendin. Mirëpo forcat shqiptare, të udhëhequra nga Ali Pashë Gucia, Hodo Sokoli etj., i zmbropsën forcat malazeze, duke iu shkaktuar disfatë. Ndërkohë, Fuqitë e Mëdha, në qershor të vitit 1880, vendosën që në vend të Hotit dhe Grudës t’i jepnin Malit të Zi Ulqinin me rrethinë. Sërish malazezët pësuan humbje në përballje me forcat shqiptare. Ata kërkuan ndihmë nga Porta dhe Fuqitë e Mëdha. Trupat e Perandorisë Osmane sulmuan mbrojtësit shqiptarë të Ulqinit, ndërsa Fuqitë e Mëdha dërguan një flotë me 17 anije në bregdetin e këtij qyteti. Forcat e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, të ndodhur në mes të sulmeve të pareshtura të ushtrisë malazeze dhe asaj osmane, si dhe përballë kërcënimit të Fuqive të Mëdha, u detyrua të tërhiqeshin më 26 nëntor 1880. Pas shuarjes së Lidhjes, u shpërbë edhe ushtria e saj, e cila në vitet e pastajme veproi përmes grupeve të vogla kryengritëse. (Frashër Demaj)

V

VADINGTON Viliam Anri (William Henry Waddington) (1826-1894). Kryeministër dhe ministër i Punëve të Jashtme i Francës, përfaqësues i Francës në Kongresin e Berlinit (1878).



VILIAM ANRI
VADINGTON

Lindi në Sentnt-Remy (Francë), në familjen e një industrialisti britanik, të natyralizuar si qytetar francez. Studimet e larta i përfundoi në kolegjin Trinity, Universiteti i Kembrixhit (1849). Që prej vitit 1860 iu përkushtua politikës, u zgjodh përfaqësues në Dhomën e Deputetëve (1871) dhe në Senat (1876). Përvoja e tij në ekzekutivin francez nisi me postin e ministrit të Punëve Publike dhe vijoi me atë të ministrit të Punëve të Jashtme (1877-1879), duke arritur më pas postin e kryeministrit (1879). Në cilësinë e ministrit të Punëve të Jashtme, Vadington përfaqësoi Francën në Kongresin e Berlinit (1878). Ishte ideator i propozimit të Protokollit 13 për përcaktimin e vijës së kufirit mes Perandorisë Osmane dhe Greqisë, e cila duhej të ndiqte rrjedhën e lumenjve Kalamas-Selevria. Sipas këtij propozimi, Preveza, Margëlliçi, Ajdonati, Reshadija, si dhe pjesa më e madhe e kazazë së Janinës, zona këto të banuara në shumicë nga popullsi shqiptare, duhej t'i kalonin shtetit grek. (Ledia Dushku)

VAJGAND Gustav (Weigand) (1860-1930). Gjuhëtar gjerman, romanist, albanolog e ballkanolog. Lindi në Duisburg të Gjermanisë, studimet për gjuhë romane i kreu në Lajpcig dhe u doktorua për gjuhën e vllahve në Livadia të rajonit të Malit Olimp më 1888. Më 1893 themeloi Institutin rumun në Universite-



GUSTAV VAJGAND

tin e Lajpcigut. Punoi si profesor i filologjisë romane. Mbahet si studiues i rëndësishëm i arumanishtes dhe i rumanishtes. Pas Institutit rumun dhe atij bullgar dhe grek në Lajpcig më 1925, G. Vajgand hapi edhe një institut shqiptar. "Balkan-Archiv" është revistë e themeluar prej tij, e cila u botua për 3 vjet (1925-1928). U mor edhe me studimin e gjuhëve të tjera të Europës Juglindore, sidomos me shqipen dhe bullgarishten. Dukuritë e përbashkëta të këtyre tri gjuhëve i lidhi me një substrat të përbashkët trak. Që përfaqësuesi kryesor i tezës se shqipja buron nga trakishtja. Botoi: "Gramatikë e gegërishtes jugore" (Albanesische Grammatik im Südgegische Dialekt, Lajpcig 1913), pastaj "Fjalor gjermanisht-shqip dhe shqip-gjermanisht" (Albanesisch-deutsches und deutsch-albanesisches Wörterbuch, Lajpcig 1914), "Etnografia e Maqedonisë" (Ethnographie von Makedonien, Lajpcig 1924). Përktheu gjermanisht disa këngë të "Lahutës së Malcis" të Fishtës (1925). Ishte anëtar i Akademisë Rumune (1892), anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave të Bullgarisë dhe anëtar i Institutit Shkencor të Maqedonisë. (Mensur Vokri)

VAKËFI. Në të drejtën islame vakëfi është pasuri që kalon nga pronësia e bamirësit në përdorim të gjerë, për të ndihmuar të varfrit, bonjakët ose për qëllime të tjera bamirëse, arsimore, kulturore etj. Vakëfi në botën islame ka zanafillë të hershme, ndërsa në hapësirat shqiptare ka ardhur bashkë me sistemin osman. Shqiptarët e kësaj periudhe kanë lënë vakëfe në vendlindjet e tyre, por edhe gjithandej nga

shtrihej Perandoria Osmane. Vakëfi i parë ndër shqiptarët ishte ai i Manastirit, të cilin e themeloi Sungur Çausheu në vitin 1434. Pastaj vijnë: vakëfi i poetit Suzi nga Prizreni, i themeluar më 1513 dhe vakëfi i opojarit Mehmet Kukli beu, i vitit 1538, që ishte ndër vakëfët më të mëdhenj. Vakëfe kanë lënë edhe personalitetet dhe pinjollët e familjeve të shquara, si: Bushatlinjtë e Shkodrës, Mahmutbegollët e Pejës, Rrotllajt e Prizrenti, Gjinollët e Prishtinës, Kryezinjët e Gjakovës dhe shumë familje të tjera të njohura. Gjithashtu vakëfe në Kosovë kanë lënë individë edhe personalitetet e shquara me origjinë shqiptare, që kishin arritur postet më të larta në shtet, si bejlerbej, admiralë të flotës dhe kryeministra (sadrizazemë). Të rralla janë vendbanimet rurale dhe urbane të Kosovës, ku të mos ketë një a më shumë vakëfe dhe objekte bamirësie. (Resul Rexhepi)

VAKIQ Ilija (1932-). Politikan. Lindi në Mitrovicë, shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, ndërkaq Shkollën e Lartë Politike e kreu në Beograd. U bë anëtar i Partisë Komuniste të Jugosllavisë më 1949, një kohë punoi në kombinatin “Trepça”, pastaj ishte sekretar i Komitetit Komunal të LK-së në Vushtrri dhe Mitrovicë. Më pas u zgjodh sekretar i Komitetit Krahinor të LK-së të Kosovës dhe anëtar i Komitetit Qendror të LKJ-së. Prej vitit 1968 ishte në funksione të larta në Kosovë dhe si përfaqësues i Kosovës në Federatën Jugosllave. Për një mandat ishte Kryetar i Këshillit Ekzekutiv të Kosovës (1970-1974). Në vitin 1974 zgjidhet kryetar i Odës Ekonomike të Jugosllavisë. Në vitin 1981 zgjidhet kryetar i Kuvendit të Kosovës. Pasi përfundon mandatin shkon në Beograd, në organet federative, si përfaqësues i Kosovës, ku pensionohet. Gjatë karrierës politike ishte luajal ndaj politikës zyrtare të Kosovës. (Ali Cenaj).

VAKU Lotë (Ismail Abazi) (1895-1960). Pjesëtar i lëvizjes kaçake, antikomunist. Lindi në Poliqkë të Kamenicës. Ishte në shërbim të ushtrisë osmane, kur shpërthyen luftërat ballkanike. Që në Luftën e Parë Ballkanike u largua nga ushtria osmane dhe u kthye në vendlindje. Deri më 1924 bëri jetë kaçake dhe luftoi kundër forcave serbe. Gjatë Luftës së Parë Botërore, në vjeshtë të vitit 1916, së bashku me çetën e tij vrasin disa vojvodë të komitëve serbë.

Pas këtyre aksioneve, deri në vitin 1924 jetoi në ilegalitet të thellë. Në vitin 1924 u shpërngul në Shqipëri. Me fillimin e Luftës së Dytë Botërore dhe me kapitullimin e Jugosllavisë (1941) u kthye në vendlindje. Ai u rreshtua në anën e forcave nacionaliste të prirë nga Idriz Hajrullahu. Në Kuvendin e Zarbicës (1944) u zgjodh anëtar i shtabit drejtues të forcave të rezistencës në Kosovën Lindore. Mori pjesë edhe në Luftën e Gjilanit dhe më pas, me disa bashkëluftëtarë, kaloi prapë në ilegalitet, duke u strehuar në male. Në vitin 1947 u detyrua të dorëzohet te organet e pushtetit. U dënua me 12 vjet burg të rëndë. Vdiq në Velekincë të Gjilanit. (Naim Musliu)

VAKUUMI KUSHTETUES NË KOSOVË (1999-2001). Situatë e mungesës së Kushtetutës në Kosovën e pasluftës, në dy vitet e para të sundimit të UNMIK-ut. Nga 25 korriku i vitit 1999 deri më 15 maj 2001, Kosova qeverisej nga UNMIK-u, mbi bazën e Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1244/99, pa akt kushtetues. Kombet e Bashkuara, për shkak të kundërshtimit të Rusisë në Këshillin e Sigurimit, refuzonin çfarëdo ideje për një kushtetutë të Kosovës, duke u mbështetur në nenin 11 të Rezolutës 1244/99, ku thuhej se “Kosova është pjesë e RFJ-së”. SHBA-ja kërkonte një akt kushtetues, me të cilin do të rregullohej transicioni drejt qeverisjes së Kosovës nga institucionet legjitime vendore. Në atë periudhë shoqëria civile bënte presion për një Kushtetutë të Kosovës, me ç’rast ishin hartuar dy versione të Kushtetutës së Kosovës: njëri nga Forumi Kushtetues i Kosovës (60 ekspertë juridikë të Kosovës brenda Institutit të Kosovës për Integritet Euroatlantike) dhe tjetri nga ekspertët juridikë të prirë nga Adem Demaçi. Mediet e Kosovës në fund të vitit 2000 botuan të dy versionet e kushtetutave të shoqërisë civile. Asnjëra nuk u pranua nga Përfaqësuesi Special, Hans Hakerup, por ky presion i shoqërisë civile bëri që në shkurt të vitit 2001 të formohet grupi prej 15 ekspertësh vendorë dhe ndërkombëtarë, të cilët hartuan Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, e cila më 15 maj 2001 do të promulgohet si Rregullorja e UNMIK-ut 2001/9. Që atëherë e deri në pavarësimin e Kosovës, Korniza Kushtetuese ishte akti më i lartë juridik në Kosovë. Vetëm më 3 maj 2008, me aprovimin e Kushtetutës së Republikës së

Kosovës, Kosova u bë me kushtetutën e saj. Pas Kushtetutës së KSA të Kosovës (1974) dhe Kushtetutës së Kaçanikut (1990), Kosova mbeti plot 18 vjet pa kushtetutë. (Blerim Reka)

VALA Erzen (1966-). Piktore. Lindi në Gjakovë, ku kreu shkollimin fillor dhe të mesëm. Kreu Fakultetin e Arteve (drejtimi i pikturës) në Prishtinë (1991). Ishte pedagog i artit figurativ në Shkollën fillore “Mazllom Këpuska” në Gjakovë (1997/2007), pastaj u zgjodh drejtor i Teatrit Kombëtar të këtij qyteti, detyrë që e ushtroi deri në vitin 2011. Ishte edhe koordinator i galerisë së artit “Vizioni i Ri 2000+” në Gjakovë (2000-2007). Realizoi gjashtë ekspozita personale (1992 /96), prej të cilave pesë në Qendrën e Kulturës dhe në Galerinë “Tyynta Myrskyn Edela”, në Turku (Finlandë), si dhe një në Gjakovë. (Blerim Luzha)

VALA Nesim (1936-2016). Mësimdhënës, gjeograf. Lindi në Gjakovë, u shkollua në Gjakovë dhe në Prishtinë, ku kreu edhe studimet në katedrën e gjeografisë të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës (1967). Ndoqi studimet pasuniversitare në Universitetin e Zagrebit, në degën e gjeografisë, ndërsa u doktorua në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës në fushën e metodikës së gjeografisë. Është autor i librit “Metodika e mësimi të gjeografisë”, që u ribotua disa herë. Derisa u pensionua punoi në Shkollën e Lartë Pedagogjike të Gjakovës dhe pastaj në Fakultetin e Edukimit, dega në Gjakovë, ku mbajti ligjërata nga disa lëndë mësimore. Një kohë të shkurtër mbajti ligjërata nga metodika e mësimi të gjeografisë edhe në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore, departamenti i gjeografisë, në Prishtinë. Në vitin 2015 publikoi librin “Kjo është Gjakova”, në të cilin shqyrtohen aspekte të ndryshme gjeografike, historike, kulturore, etnologjike etj. Ka botuar disa artikuj e trajtesa në revistat shkencore dhe profesionale. (Hivzi Islami)

VALA-SIQANI Sali (1910-1945). Veprimtar politik, komandant i Batalionit “Nazim Gafurri”. Lindi në Prishtinë në një familje të njohur. Gjyshi i tij, Veliu, ishte pronar tokash, pronar i bujtinës dhe kishte disa dyqane në qendër të Prishtinës. Për t’i shpëtuar persekutimit të pushtetit, familja u detyrua ta ndërrojë mbiemrin nga Selimi në Vala e më pastaj në

Siqani. Ditën e hyrjes së ushtrisë gjermane në Prishtinë, në mëngjesin e 8 prillit të vitit 1941, në dyqanin e S.Siqanit u vendos flamuri kombëtar (i qëdisur nga Naxhie Batalli). Më pas S. Siqani ishte ndër drejtuesit e luftimeve në mbrojtje të kufirit nga forcat partizane serbe në Prapashticë. Në shtator të vitit 1944 u zgjodh anëtar i Komitetit Qendror të Organizatës së Rinisë Nacionaliste për Mbrojtjen e Atdheut dhe komandant i Batalionit “Nazim Gafurri”. Pas Luftës së Dytë Botërore tentoi të arratisej për në Greqi. U zu nga forcat ushtarako-police jugosllave dhe u zhdruk pa gjurmë. Regjimi komunist në vitin 1945 e shpalli “armik të popullit” dhe ia konfiskoi tërë pasurinë. Lidhja Kosovare në Kongresin e Parë Botëror në Çikago, në vitin 1973 e shpalli hero kombëtar (Sulltane Ukaj)

VALLA Esat (1944-). Piktore. Lindi në Gjakovë. Kreu shkollimin fillor në vendlindje, Shkollën e Mesme të Artit në Pejë, ndërsa u diplomua në Akademinë e Arteve Figurative në Beograd (1971). Nga viti 1976, derisa u pensionua, ishte pedagog në Akademinë e Arteve në Prishtinë. Është anëtar i Shoqatës së Artistëve Figurativë të Kosovës dhe ka marrë pjesë në aktivitetet ekspozuese të saj brenda dhe jashtë vendit. Bëri udhëtime studimore në Itali, Francë, Spanjë, Portugali, Çeki, Poloni, Greqi etj. Është piktore lirik, që trajton elementin e ngjyrës së ngrohtë të shfaqur më së miri në ciklin “Dritarja”, i cili është realizuar me një frymë lirike. I takon brezit të mesëm të krijuesve të artit pamor në Kosovë. Hapi një sërë ekspozitash personale, duke filluar që nga viti 1972 (Beograd, Prishtinë, Prizren, Shabac, Gjakovë, Pejë, Tiranë, Oslo, Stamboll) pastaj më 1991 në Galerinë e Arteve në Prishtinë, në Galerinë e qytetit të Gjakovës “Vizioni 2000 +” (2001), më 2003 në Galerinë Kombëtare të Arteve në Tiranë si dhe më 2013 në Galerinë e Arteve të Kosovës në Prishtinë. Është pjesëmarrës i shumë ekspozitave të përbashkëta, kombëtare e ndërkombëtare dhe fitues i disa çmimeve, duke filluar që nga Salloni Pranveror i vitit 1974, i çmimit me rastin e 100-vjetorit të Lidhjes së Prizrenit (1978), i Sallonit VII Pranveror (1980), i çmimit për pikturë në konkursin “Shpërngulja plagë shekullore e popullit tonë” (1994) etj. (Hivzi Muharremi)

VALLA Klodian (1980-). Piktore. Lindi në Gjakovë. Kreu shkollën fillore dhe të mesmen në

Prishtinë; Fakultetin e Arteve (dega e pikturës) gjithashtu në Prishtinë më 2003. Ishte ligjërues i lëndës vizatimi i lirë në një kolegji privat. K. Valla realizoi tri ekspozita personale, ndërsa me punimet e tij mori pjesë në disa ekspozita kolektive në Kosovë, Francë dhe në Gjermani. Mori disa çmime, midis të cilëve edhe çmimet e para për pikturë në Sallonin XXIX dhe XXXIV të Nëntorit në Prishtinë, pastaj çmime dhe mirënjohje të ndryshme. (Blerim Luzha)

VALLET E BURRAVE. Janë pjesë e vallëzimit popullor shqiptar. Përfshin kërcimet tradicionale në festa e argëtime popullore. Janë të natyrës epike që karakterizohen nga burrëria, trimëria, karakteri luftarak, madhështia. Luhen kryesisht nga burrat, por edhe bashkë me gratë. Janë valle luftarake, si “Loja me jataganë” (Rugovë) dhe epike, rrethore, të Labërisë. Janë të strukturuar e të shpërndara sipas krahinave etnokulturore. Në zonën isopolifonike i gjejmë me dy rreshta kryesisht të kënduara, ndërsa në pjesën tjetër i hasim me shoqërim instrumental. Tradita popullore në koreografi i emërton sipas trevave, nisur dhe nga ndërtimi i brendshëm: valle labe, çame, myzeqare, devolliçe, mirditore, dibrane, zadrimore, kosovare, rugovase, kërçovare, arbëreshe etj. Referuar studimeve të etnokoreologjisë shqiptare, disa tipa klasifikohen: dyshe, treshe, katërshe. Sipas formacionit ndahen në valle masive e kërcime vetjake. Në vallet masive vërehen tre tipa: vallet në rreth të mbyllur, në gjysmërreth, në dy vija përballë njëra-tjetrës. Kërcimet vetjake ndahen në pesë tipa: kërcime njëshe, dyshe, treshe, katërshe dhe kërcime në grup. Sipas strukturës dallohen trajtat e kërcimit njëpjesëshe e dypjesëshe. Disa emërtime lidhen me bashkëveprimin strukturor ndërmjet muzikës dhe koreografisë, si: “Vallja e pipëzave”, “Kcim me kavall”, “Vallja e lodrës”, “Ojna e tupanit”, “Vallja e thuprës”, “Vallja e curlës”, “Qemania e vogël”, “Kcim fyelli”, “Vallja e tamrës”, “Vallja e gajdes”, “Valle me def”, “Kcim me çifteli”, “Valle me saze”. (Vasil S. Tole)

VALLET E FEMRAVE. Kërcehen nga femrat dhe transmetojnë emocione të larmishme me karaktere të specifikuar. Ndër vallet më të spikatura janë vallet rituale, vallet e dasmës, vallet erotike, vallet humoristike etj. Kanë karakter lirik dhe kërcimi i tyre krijon atmosferë elegante e poetike, ndërkohë që

gjenden dhe me karaktere të përziera: liriko-epike, heroike etj. Vallet e femrave janë të përhapura në gjithë Shqipërinë. Krahinat malore të Shqipërisë së Mesme e Veriore dhe Kosova e vise të tjera dallohen për kërcimet e grave që luhen nga një, dy ose më shumë valltare të shkëputura njëra nga tjetra me kërcim të lirë. Në pasurinë koreografike të trevave veriore tërheqin vëmendjen vallet me emërtime karakteristike, sidomos në Lumë, Malësi të Gjakovës, Malësi të Madhe, Rrafsh të Dukagjinit, Rugovë, Drenicë etj. Ndër vallet më të njohura të femrave në Kosovë është “Vallja e Shotës”. Luhet në disa variante: dy gra a vajza, një grua e një burrë ose edhe dy çifte. Është valle lirike që luhet në tubime festive, më shumë gjatë festimit të dasmës. Shoqërohet me forma të ndryshme vokale-instrumentale. Figura e emocione të ngjashme shprehin dhe vallet e krahinave të Dropullit, vallet me prejardhje nga fshati Dardhë i Korçës. Këto të fundit shfaqen me forma të ndryshme organizimi, ku valltaret kërcejnë në formacion gjysmërrethi, të kapura për duarsh zinxhir, duke u zhvendosur në varg nga e djathta dhe të shoqëruara me këngë. (Fatmir Hysi)

VALLET POPULLORE SHQIPTARE. Janë pjesë shumë e rëndësishme e trashëgimisë etnomuzikore të popullit tonë. Si krijimtari dhe aktivitet artistik popullor, vallja është njëra ndër



VALLE E RUGOVES

format më të vjetra të shprehjes dhe ka tipare të dallueshme në krahasim me vallet e popujve të tjerë. Duke qenë pjesë e pandashme e folklorit në përgjithësi, vallja merr tiparet e saj veçuese në momentin e trajtimit të saj në aspektin etnografik krahinor. Në literaturën studimore etnokoreologët kanë bërë klasifikimin e valleve

sipas grupimit, pjesëmarrjes gjinore, krahinore dhe ndërtimit strukturor të tyre. Grupin e parë të valleve tona e përbëjnë vallet epike dhe vallet lirike. Vallet klasifikohen edhe sipas aspektit gjeografik: vallet e Shqipërisë së Veriut (ku hyn edhe Kosova), të Shqipërisë së Mesme dhe të Shqipërisë së Jugut. Brenda grupimeve të mëdha vijnë edhe nënndarje në zona etnografike më të specifikuar, si p.sh. vallet e Karadakut, të Hasit, të Opojës, pastaj vallet e Lungjërës, të Tepelenës, të Rugovës etj. Si vallet epike, ashtu edhe ato lirike kanë nënlojet e veta. Vallet lirike mund të jenë: valle të punës, rituale, valle të dasmës, valle me tipare erotike, valle humoristike, pantomimë etj. Vallet epike ndahen në valle luftarake, valle epike trimërie, por brenda tyre ka edhe valle të gërshetuara epiko-lirike etj. Vallet popullore shqiptare ndahen edhe sipas formacionit, si valle masive dhe kërcime solistike. Në vallet grupore bëjnë pjesë tri lloje kryesore: vallet me rreth të mbyllur, vallet në gjysmërreth dhe vallet në rend përballë njëra-tjetrës. Ndërsa kërcimet solistike janë kërcim njëshe, dyshe dhe kërcim në grup. Vallet popullore shqiptare ndahen edhe sipas gjinisë: në valle të burrave, valle të grave, valle të fëmijëve dhe ato të përziera. Vallet realizohen me shoqërim instrumental (me instrumente tradicionale). Gjithashtu njihen edhe vallet e kënduara dhe vallet e heshtura. Këto forma kërcimi mbajnë veçoritë e tyre karakteristike, varësisht nga treva ose nga zona ku janë të pranishme. Ndër studiuesit më të njohur të valleve popullore shqiptare është etnokoreologu, Ramazan Bogdani, i cili ka mbledhur dhe studiuar edhe vallet nga viset e Kosovës, sidomos ato të Rugovës, të Opojës dhe Hasit. (Visar Munishi)

VARFËRIA DHE VARFËRIA E SKAJSHME.

Varfëria shpreh gjendjen në të cilën popullsia ose një pjesë e saj nuk posedojnë mjete të mjaftueshme për të plotësuar nevojat themelore për jetesë. Varfëria definohet në terma absolute dhe relativë. Niveli i varfërisë absolute në një vend shpreh numrin e personave që jetojnë nën kufirin absolut të varfërisë. Kufiri i varfërisë absolute indeksohet në vazhdimësi gjatë viteve, nga secili vend, për të reflektuar kështu ndryshimet e çmimeve të një shporte të caktuar të konsumit. Në kuadër të përlllogaritjes së nivelit të varfërisë absolute, identifikohet edhe ajo pjesë e popullsisë, e cila

nuk mund të përmbushë as nevojat ditore për mbijetesë, pasi shpenzon më pak se kufiri apo pragu i caktuar. Kjo pjesë e popullsisë, konsumi i të cilëve nuk e arrin as pragu e mbijetesës, klasifikohen si individë ose familje që jetojnë në varfëri të skajshme. Për varfërinë relative, pragu i varfërisë nuk është fiks, por ndryshon me përmirësimin e standardit jetësor të shoqërisë në tërësi.

Matja dhe raportimi i varfërisë në Kosovë bazohet në konceptin e varfërisë absolute, për arsye se Kosova është vend në zhvillim dhe një pjesë e popullsisë nuk arrin t'i përmbushë nevojat themelore për ushqim dhe veshmbathje. Mirëqenia e shoqërisë matet përmes konsumit, prandaj edhe shifrat mbi shkallën e varfërisë në Kosovë shprehin varfërinë në konsum. Linja e varfërisë dhe e varfërisë së skajshme përlllogaritet në bazë të metodës së përcaktimit të kostos së shpenzimeve, bazë që identifikon një shportë konsumi me gjëra ushqimore dhe joushqimore. Të dhënat mbi konsumin mbledhen përmes anketës së buxhetit të ekonomive familjare, ku bëhet vlerësimi i konsumit të ekonomive familjare, duke përjashtuar shpenzimet për qira dhe për gjëra me përdorim afatgjatë. Vlera e këtij konsumi për familje më pastaj pjesëtohet me numrin e ekuivalentit të të rriturve në atë familje, për të reflektuar edhe madhësinë demografike të ekonomisë familjare. Përbërësit ushqimorë në vlerë prej 2,100 kcal në ditë përcakton linjën e varfërisë së skajshme, e kur të shtohen edhe përbërësit joushqimorë, del linja e varfërisë absolute. Kështu, në përputhje me ndryshimin e çmimeve, kufiri i varfërisë dhe i varfërisë së skajshme në Kosovë në vitin 2009 ka qenë 1.55 euro dhe 1.02 euro për një të rritur në ditë. Në vitin 2011, për të reflektuar ndryshimin e çmimeve gjatë kësaj periudhe, kufiri i varfërisë absolute dhe të skajshme ishte 1.72 euro dhe 1.20 euro në ditë. Për më tepër, sipas anketës së standardit jetësor të kryer nga Banka Botërore në vitin 2000, varfëria në Kosovën e pasluftës ishte e lartë, ku rreth 40% e popullsisë jetonin në varfëri absolute dhe 12% në varfëri të skajshme. Këto të dhëna listuan Kosovën si njërin ndër vendet më të varfra në rajon dhe Europë. Por kjo gjendje nuk ka ndryshuar dukshëm as më vonë (viti 2015), pasi Kosova vazhdon të jetë vendi më i varfër në rajon me mbi 30% të popullsisë që jetojnë në varfëri absolute, ku 10% prej tyre jetojnë në varfëri të

skajshme. Varfëria në Kosovë vazhdon të jetë e shprehur në zonat rurale, në familjet që kanë më shumë anëtarë, si dhe me numër të madh të papunëve ose punëtorëve ditorë. (Venera Demukaj)

VARIBOBA Jul (1724 ose 1725-1788). Lindi në Mbuzat (S. Giorgio Albanese, Kalabri). Ka studiuar në Kolegjin Korsini të Shën Benedeto Ulano. Më 1749 është dorëzuar prift. Më 1751



JUL VARIBOBA

është emëruar rektor i Kolegjit. Ka qenë i angazhuar në polemika publike dhe ka shprehur parapëlqime për ritin latin, për çka ka pasur fërkime brenda fshatit. Më 1751 ka dhënë dorëheqje si rektor. Ka vazhduar si ekonom. Më 1761 ka mërguar në Romë, ku ka shërbyer si prift dhe ka qëndruar deri në vdekje. Në Romë ka botuar veprën “Gjella e shën Mërisë Virgjër” (Ghiella e S. Mërisë virgjiær. Scruar mbë viers Arbërijt caa gnë Prift puru i Arbëres për ndeert afaj Regin e par Jpafs të atire divotrave, cia fë duan të chëndognën chëncch namurije; ma duan të ðeen chëncch’ Spirituaal mbë trij manerës: mbë Calimeer, mbë canghiell’ e mbë gn’ater Jort chëndimmi LëtiJt: Vergine bella. Romm. MDCCLXII. Me licenz të P. Maistrit. Scitten MbuJfat caa Nofji.). Në fillim ka dy fjalë parathënieje. “Oj e ndërmja Rrexhin” i drejtohet Shën Mërisë me një humor të lehtë për t’i rrëfyer se nuk njihnte ndonjë poezi arbërisht që do të rrëfente gjithë jetën e saj, gëzimet, dhembjet e thumbimet e zemrës sa ishte në këtë jetë dhe për t’i kërkuar ta ndjente në ditën e gjyqit për mëkatet e rinisë, kur kishte lexuar dhe shkruar vargje italisht për të qeshur o për të kënduar. Po ashtu rrëfente se po shkruante në një gjuhë “aq frushkullorea, aq çota, aq e përbetalëmea”, sa të duket se me të nuk mund të thuhet gjë tjetër pos “mallkime, nëm’, të shara, o veramende për turp”, por që duhej ta merrte si një frut të egër, por të ëmbël, të kënduar me devocion. “Oj ti që dhjvasën” (Oj ti që lexon) i drejtohet lexuesit. Kemi një vepër me dy pjesë dhe disa vjersha lirike, që përmban 4,700 vargje. Vjershat lirike vijnë tematikisht si plotësim i poemës. Mbahet vepra e parë arbërisht me vlera të mirëfillta artistike, me një stil popullor, me subjekt fetar, por që shpesh

largohet nga trajtimet e zakonshme duke sjellë risinë që mjaft prej figurave biblike i portretizon si njerëz të zakonshëm, duke ndërshtënë elemente nga poezia popullore arbëreshe apo të valleve e të vajtimeve tradicionale, të ndonjë ninulle. Gjuha e Varibobës në këtë vepër është arbërishtja e vendlindjes me plot italianizma. (Rexhep Ismajli)

VARIOLA VERA (LIA NATYRALE). Është njëra ndër sëmundjet më të vjetra dhe më vrastare me të cilat është përballur njerëzimi. Besohet se variola është paraqitur në shoqërinë njerëzore rreth 10,000 vjet para epokës së re. Djepi i kësaj sëmundjeje llogaritet të jetë Afrika Qendrore. Në Europë ka pasur disa epidemi të variolës (1614, 1710, 1723), të cilat kanë zhdukur qindra mijëra njerëz. Rasti i fundit në Europë u regjistrua në vitin 1972, në Kosovë dhe ish-Jugosllavi. Epidemiologët jugosllavë deklaruan se variolën e kishte sjellë një pelegrin kosovar nga Basra e Irakut, por pas një përpunimi detal të epidemisë konstatuam se kjo e dhënë nuk qëndron. Prej vitit 1976, variola vera nuk regjistrohet më. Organizata Botërore e Shëndetësisë në vitin 1978 proklamoi botën pa variolë dhe kjo konsiderohet fitorja më e madhe e shëndetësisë botërore. (Salih Ahmeti)

VARVARICA Ramiz (1900-1938). Veprimtar i lëvizjes demokratike, pjesëmarrës i Luftës Qytetare të Spanjës (1936-1939), Hero i Popullit në Shqipëri. Lindi në Dibër. Në moshën e rinisë punoi çirak, kurse në vitet 1919-1920 punoi në milicinë e shtetit të Shqipërisë dhe mori pjesë në mbrojtje të Kongresit të Lushnjës dhe të qeverisë së Sylejman Delvinës. Në vitin 1921 me forcat dibrane luftoi kundër ushtrisë së Mbretërisë Serbe-Kroate-Slllovene, e cila kishte depërtuar në krahinat lindore shqiptare. Së bashku me forcat e Bajram Currit luftoi dhe kontribuoi në shpartallimin e mercenarëve të Gjon Marka Gjonit, i cili kishte shpallur të ashtuquajturën Republikë e Mirditës. Mori pjesë në Revolucionin e Qershorit të vitit 1924 në Shqipëri dhe u angazhua për realizimin e programit të tij si anëtar i shoqërisë “Bashkimi”. Pas rrëzimit të qeverisë së Fan S.Nolit migroi në Itali e pastaj në Francë, ku jetoi e punoi gjatë viteve 1925-1936. Në Francë u aktivizua në lëvizjen punëtoare franceze dhe bashkëpunoi me emigracionin shqiptar. Pas shpërthimit të Luftës Qytetare të Spanjës (1936) u paraqit

vullnetar në brigadat internacionale. Si ushtarak kreu detyra me përgjegjësi dhe u dallua për trimëri. U vra në Kaspa të Aragonës. (Zijadin Gashi).

VARREZAT E HEBRENJVE NË PRISHTINË. Gjenden në Taul Bahçe të Prishtinës, dikur në periferi të qytetit, tani pranë lagjes së banuar të asaj zone, Velanisë. Datojnë nga shek. XIX, kur numri i pjesëtarëve të Komunitetit Hebraik në Prishtinë ishte rreth 1,500. Aktualisht gjenden gjithsej 57 varre. Deri në vitin 2011 varrezat ishin në gjendje jo të mirë dhe më pas u rregulluan nga një grup studentësh ndërkombëtarë dhe kosovarë. (Qemajl Morina)

VASA Pashko (1825-1892). Shkrimtar, njëri nga ideologët e Rilindjes Kombëtare. Lindi në Shkodër. Ishte kryesisht autodidakt, me përjashtim të mësimëve që mori italisht në



PASHKO VASA

vendlindje dhe në Venedik. Filloi të punonte që më 1842, si sekretar në nënkonsullatën britanike në Shkodër, më pas u shpërngul në Itali, i angazhuar si oficer në Romë e më pas në Venedik. Më 1849 gjendet në Stamboll, fillimisht si nëpunës në një ndërmarrje tramvajesh, më pas në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Perandorisë Osmane e në Ambasadën e saj në Londër. Qëndroi në Shkodër nga viti 1857 deri më 1863, më vonë në Bosnjë e Hercegovinë si sekretar përkthyes i misionit perandorak. Nga 1864 u emërua në disa misione e komisione zyrtare nga Perandoria. Ishte njëri nga organizatorët e Lidhjes së Prizrenit, anëtar i Komitetit Qendror për Mbrojtjen e të Drejtave të Kombësisë Shqiptare, një ndër themeluesit e Shoqërisë së të Shtypurit të Shkonjave Shqip, anëtar i Komisionit të Alfabetit. Më 1879 mori titullin e pashait dhe më 1883 u emërua guvernator i përgjithshëm i Libanit, post që e mbajti derisa vdiq në Bejrut. Vjersha e tij më e famshme, “Moj Shqypni”, shkruar rreth viteve 1880, bashkë me prozën e shkurtër historike “Shqypnia dhe shqyptart” (1879) janë dy tekstet e vetme të botuara shqip nga P.Vasa. Poezia “Moj Shqypni” mund të konsiderohet si një nga tekstet më të rëndësishme për nga

vendlindje dhe në Venedik. Filloi të punonte që më 1842, si sekretar në nënkonsullatën britanike në Shkodër, më pas u shpërngul në Itali, i angazhuar si oficer në Romë e më pas në Venedik. Më 1849 gjendet në Stamboll, fillimisht

funksioni e ndikimi për idetë dhe frymën e Rilindjes Kombëtare. Mbetet një nga poezitë më të ribotuara në shqip (madje edhe e kënduar si himn me melodi të Rinski-Korsakov gjatë luftimeve për mbrojtjen e tokave shqiptare), e përhapur që nga fletushkat në periudhën pas Lidhjes së Prizrenit, deri te pothuaj të gjitha tekstet shkollore. Suksesi i kësaj poezie tipike romantike i detyrohet jo vetëm ndërtimit antitetik, por edhe prozodisë, ritmit marcial e toneve herë të larta e herë elegjiake. Proza “Shqypnia dhe shqyptart”, e botuar në përmbledhjen e punimeve “Abetare e gluhësë shqip” (1879) ua bën të njohur shqiptarëve historinë e tyre si pasardhës të pellazgëve, ilirëve, Teutës dhe Gencit, e sidomos përqendrohet në periudhën e Skënderbeut, që zë gati një të tretën e veprës. Pjesa tjetër e veprës së P.Vasës është shkruar në frëngjisht dhe italisht: “Burgimi im, episod historik për rrethimin e Venedikut” (1850), “Bosnja dhe Hercegovina gjatë misionit të Xhevdet Efendiut” (1865), “Vështrim historik mbi Malin e Zi sipas traditave shqiptare” (1872), “Trëndafila e gjemba” (1873, një përmbledhje lirikash personale në frymën e romantizmit italian), “Alfabeti latin përdorur për gjuhën shqipe” (1878), “Studime për Shqipërinë dhe shqiptarët” (Stramboll, 1879), që u botua në Paris më 1879 me titullin “E vërteta mbi Shqipërinë dhe shqiptarët, studim historik dhe kritik” dhe më pas në gjermanisht e anglisht (1879), turqisht e greqisht (1880) dhe arabisht (1884), ndërsa shqip vetëm në vitin 1935. Kjo është vepra e parë dhe ndoshta më e rëndësishmja mbi idetë e Rilindjes, ku P. Vasa i mëshon më shumë kontrastit mes të shkuarës së lavdishme dhe aktualitetit shqiptar. Më 1887 u botua në Londër “Gramatika shqipe për ata që dëshirojnë ta mësojnë këtë gjuhë pa ndihmën e mësuesit”. Vepra e fundit e P.Vasës romani “Bardha e Temalit. Skena të jetës shqiptare”, i botuar frëngjisht më 1890, është i pari roman me temë shqiptare. Të gjitha veprat e shkruara në gjuhë të huaj janë botuar në shqip me një vonesë të madhe dhe kanë pasur fare pak ndikim në procesin letrar shqiptar. (Dhurata Shehri)

VATO CI Jusuf (1936-). Mësimdhënës i informatikës. Lindi në Novolan të Vushtrrisë, shkollën fillore e kreu në Vërnice, ndërsa Normalen në Prishtinë. Studimet për fizikë i kreu në Fakultetin e Shkencave Matematike-

Natyrore të Universitetit të Prishtinës. Studimet pasuniversitare i kreu në Universitetin e Zagrebit, ndërsa disertacionin e mbrojti në degën e informatikës në Universitetin e Tiranës (1994). Një kohë punoi si drejtor shkollë në fshatin Zhilivodë të Vushtrrisë, ndërsa më vonë si mësimdhënës i fizikës në shkollën e mesme “Zenel Hajdini” në Ferizaj dhe në Qendrën Shkollore Teknike në Obiliq. Më pas kaloi në Qendrën Llogaritëse të Kombinativit “Kosova”. Nga viti 1980 ishte hulumtues i pavarur në Entin për Informatikë në Institutin “Inkos”. Është autor i disa librave profesionale dhe i botimit “Leksikoni i magjistrave dhe i doktorëve të shkencave në trojet jashtë Shqipërisë 1430-1995” (1998). (Enver Hamiti).

VATOVCI Isa (1974-). Gazetar. Lindi në Novolan të Vushtrrisë. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, të mesmen në Vushtrri. Studimet për gjuhë dhe letërsi i mbaroi në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës. Nga viti 2004 punoi gazetar, së pari në gazetën e përditshme “Zëri”, më pas në agjencinë e lajmeve “Kosova live” për të vazhduar nga 2006 në gazetën “Kosova sot”. Shkruan kryesisht për zhvillimet dhe aktivitetet kulturore. Zhvillon veprimtari me publikime edhe në Klubin Politik të Shqiptarëve të Izmirit në Turqi. Është fitues i disa çmimeve për shkrime nga fusha e kulturës. (Shaqir Foniqi)

VDEKSHMËRIA. Dukurishumëdimensionale dhe afatgjate demografike, e cila paraqet komponentën negative dhe dinamike të zhvillimit të popullsisë. Ajo është variabla qendrore e zhvillimit të drejtpërdrejtë dhe afatgjatë të lëvizjes së popullsisë, veçanërisht të lëvizjes natyrore dhe strukturës së popullsisë, kryesisht sipas moshës dhe gjinisë. Në periudhën deri në Luftën e Dytë Botërore shkalla e vdekshmërisë në Kosovë ka qenë mjaft e lartë. Ajo ishte mbi 30 promilë, ndërsa vdekshmëria e foshnjave shkonte edhe deri në 200 promilë. Pas kësaj periudhe, pas përmirësimit të kushteve të përgjithshme shëndetësore dhe higjienike-sanitare, bie në mënyrë të vazhdueshme shkalla e mortalitetit në përgjithësi dhe shkalla e mortalitetit të foshnjave, në veçanti. Pas viteve ‘70 të shekullit të kaluar, në Kosovë shkalla e mortalitetit të përgjithshëm bie nën 10 promilë. Sipas vlerësimit të Agjencisë Statistike të Kosovës

gjatë vitit 2013 në Kosovë kanë vdekur 7,312 persona dhe shkalla e mortalitetit ka qenë rreth 4 promilë. (Hazer Dana)

VEGLAT MUZIKORE POPULLORE AERO-FONIKE. Në këtë kategori të veglave muzikore hyjnë: fyelli, kavalli dhe surla. *Fyelli* është me dimensione dhe emërtime të ndryshme. Përbëhet prej gypit cilindrik (dru, kallam, asht, metal, plastmasë) me disa vrima. Përdoren sidomos dy tipa: fyelli jugor (njëjarja labe) me pesë vrima dhe fyelli mesoverior me gjashtë vrima. Menzura e gypit ndryshon për nga materia. Nëse është prej kallami, ashti a shtogu, del më i shkurtër. Fyelli jugor është më i gjatë, me gyp 3-pjesësh, 7 vrima, 1 vrimë pas dhe 4 vrima në fund (nuk mbyllen). Fyelldrejti, me sqep a gojëz të prerë orienton frymën në vrimën anësore. Diapazoni varet prej gjatësisë dhe menzurës: sa më i gjatë të jetë gypit, ka tinguj më të ulët dhe anasjelltas. Numri i tingujve varet prej numrit, madhësisë e largësisë mes vrimave. Krahas tingujve diatonikë e kromatikë, përftohen dhe artikulime të ndryshme. Përdoret duke futur sqepin në gojë dhe duke e mbajtur drejt (fyelldrejti). *Kavalli* është variant popullor i flautit, me origjinë të lashtë. Përdoret edhe në vendet e tjera të Ballkanit me emërtim të përafërt. Përbëhet prej një tyte druri a metali me menzurë cilindrike e gjatësi të përafërt me të flautit. Ka një varg vrimash. Përftohen tinguj të butë, të ëmbël e të ngrohtë. Karakteri i tingullit i afrohet ambientit baritor. E përdorin barinjte në kullosa. Përdoret si instrument solo, por në disa vise të jugut ka dhe ansamble kavallesh. *Surlja* është variant popullor i obosë. Përdoret në rrethet e Prizrenit (zurlë, zurnë) dhe Ohrit (surlja). Varianti me trup më të vogël, tinguj të lartë, të thekshëm, quhet pizgë në rrethet e Strugës. E gjejmë dhe në Dalmaci (Sopila, Sopela). Surlat ndryshojnë në dimensione: surlja e madhe, surlja e vogël (Ohër, Strugë). (Zeqirja Ballata)

VEGLAT MUZIKORE POPULLORE IDI-OFONIKE. Në këtë kategori bëjnë pjesë: gurët, tokëza, rraketaçja, rrekëza, gerrëza, zilet, kambanat, tringëzat, tepsia. *Gurët* si vegël muzikore janë përdorur që herët. Përplasen ritmikisht njëri në tjetrin për pasqyrimin e lojërave, valleve, motiveve të punës. I këndohet bletës dhe kur fëmijët luajnë symbyllur. *Tokëza* (arbëreshët: troke) është më e lashtë. Përbëhet

nga një rrasë guri në trajtë katërkëndëshi, por edhe druri a metali cilindrik (çang) dhe varej horizontalisht. Qëllohej ritmikiisht me çekan. Përdorej edhe si mjet sinjalizues. *Rraketakja* sajohej nga kashta e njomë e misrit, e çarë prej së gjati në tri pjesë. E përdorin fëmijët për argëtim. *Rrekëza* sajohej prej thuprave në formë shportëze (brenda me copëza druri, guralecë, gjësede kumbuese, me dorëz në fund. *Gerrëza* është një bosht druri i dhëmbëzuar që mbaron me dorëzë. Te boshti vendoset një si katror me dërrasë të hollë në mes, e cila ndërpritet përfundi me shkop të tërthortë. Buza e dërrasës mbështetet në dhëmbëza të boshtit dhe gjatë rrotullimit dërrasa e hollë rrëshqet me kërcime nëpër dhëmbëza. Përdoret dhe në dasma (Berat) për shoqërimin e valltarëve. *Zilet* janë me dimensione e emërtime të ndryshme: perine (lopësh), takerake (dhish), cingare (dhensh), leketake (kuajsh). Ka bupet labe, këmbore dyshe (diare) e treshe (triare) me trajta që dallohen edhe nga dimensionet. *Kambanat* janë derdhur në tunxh dhe janë përdorur në kulla, kështjella e kisha që në mesjetë, për të ftuar në mbledhje dhe kuvende, për kushtrim dhe alarme. Punishte kambanash në shek. XV-XVI ka pasur në Ulqin, Pishkash, Mirditë etj. *Tringëzat* janë dy disqe të vogla metalike, të lidhur te gishti i madh dhe i mesëm, që nxjerrin kumbime për shoqërimin e valleve (Shkodra, Gjakova, Ulqini). *Tepsia* si vegël muzikore përdoret nga femrat. Rrotullohet në pozitë vertikale dhe shoqërohet me këngë. Gishtërinjtë me unaza trokasin në tepsi dhe krijojnë kumbime të lehta (Dukagjin, Rugovë). (Zeqirja Ballata)

VEGLAT MUZIKORE POPULLORE KORDOFONIKE. Në katëgorinë e veglave popullore kordofonike bëjnë pjesë: çiftelia, bugaria, tamrra, tamburaja, bakllamaja, lahuta. Çiftelia shërben për interpretime melodike, shoqërim këngësh e vallesh. Përbëhet nga trupi në trajtë gjysmë bajameje, qafa me 11-13 fusha (perde) dhe “koka” me dy çelësa akordues. Trupi punohet me dru mani, qershie, arre, gështenje a frashëri, kapaku i rrafshët, me 2-3 e më shumë hapije, nga pisha a bredhi, ndërsa qafa me urëzën dhe çelësat nga druri i ahut. Nga koka nëpër qafë kalojnë dy tela (çift/teli) dhe përfundojnë te urëza (shala) mbi kapak. Telat dridhen me penë druri qershie, puple ose briri. Akordohet në “unisono”, sekonda,

kuarta ose kuinta. Melodia luhet me telin e parë. I dyti mban iso, ostinato. Nuk ka tinguj të fuqishëm, ka mundësi teknike, dinamike, ngjyrash. *Bugaria* është e ngjashme, me tipare të përafërta ndërtimi e trajte, por më e imët, me dy tela, trup rezonues të shtypur prapa. Përdoret më rrallë në Dukagjin. Të ngjashme me çiftelinë janë *tamrra* (veri) dhe *tamburaja* (jug). *Bakllamaja* është më e madhe, me numër e strukturë tjetër fushash të pabarabarta, kokë e tre çelësa (tre tela): dy në unisono, i treti për kuintë më poshtë. Vijëzat melodike luhet me telin e parë, pjesërisht me të dytin, me të tretin mbahet isoja. Përdoret sidomos në rrethin e Korçës. *Lahuta* është përdorur te ne nga mesjeta, për shoqërimin e këngëve epike, kreshnike, baladave e rapsodive. Përbëhet nga një trup druri i zbrazët gjysmëvezak, mbi të cilin mbërthehet anash me kunja druri lëkura e regjur e edhit, lepurit apo plëndësi i bagëtive me 3-4 vrima. Përgjatë trupit, deri te koka e dhisë (simbolizon përkrenaren e Skënderbeut), kalon kordha, e mbështetur mbi urëz, e shtrënguar me kunj te koka. Në anën tjetër të trupit kapet për një të dalë druri. Trupi me qafën dhe kokën janë dru panje, verri e arre. Harku (argeci, zharku) i lakuar në formë gjysmëhëne është dru thane. Fijet e përdredhura me kordhë kali lyhen me rrëshirë pishe. Tingujt nxirren me fërkimin e harkut në kordhë e lëvizje gishtash. Lahutari rri këmbëkryq ose në gjunjë, vegla mbahet në dorë të majtë, vertikalisht, e mbështetur në gjunjë. Tingujt zgjidhen me falangat e gishtërinjve të dorës së majtë (pa gishtin e madh), duke e prekur kordhën që shtrihet larg “tastierës” dhe nuk arrin gishti në kordhë ta prekë “tastierën”. Kumbimi dhe vijëzat modale-tonale e pentatonike varen prej cilësisë së lëkurës, kordhës, harkut dhe aftësive tekniko-muzikore të lahutarit. (Zeqirja Ballata)

VEGLAT MUZIKORE POPULLORE MEMBRANOFONIKE. Në këtë kategori bëjnë pjesë defi dhe lodra. *Defi* (dajrja) përbëhet prej një rrethi druri me lëkurë të tërhequr. Përgjatë rrethit ka petëza (çampare, xhingla) metalike. Mbahet me dy duar, kur i bihet me pëllëmbë a me gishtërinj. Kur tundet, dridhet, dalin në pah petëzat metalike, duke formuar kumbime vetëtingëlluese dhe membranofonike nga vibracionet e lëkurës. Nxirren edhe theksime e kundërtheksime, varësisht nga mënyra dhe vendi ku i bihet, me gishtërinj a me pëllëmbë.

Goditet, tundet a dridhet edhe rrethi i drunjte për të nxjerrë kumbime idiofonike: mund të rrëshqasë bula e gishtit përreth defit në “glissando”, një si “frullato” membranofonike. Mund të luhet edhe duke e goditur në gjunjë e bërryl. Me def krijohen figura metro-ritmike dhe nuanca dinamike. E kanë përdorur femrat duke kënduar e shoqëruar valltaret dhe më pas edhe meshkujt për të shoqëruar këngët e vallet. *Lodra* (daullja e madhe) përbëhet nga kasa e drurit në trajtë troko-cilindrike, me lëkurë të regjur e të ngrehur me litar në të dy anët. Ka dimensione të ndryshme, varësisht nga mjedisi ku përdoret, me diametër 40-60 cm dhe thellësi rreth 20-40 cm. Mbahet e varur me një rrip krahaqafë dhe në njërin anë goditet me thupër, ndërsa në anën tjetër me shkop të trashë me gungë. Kur qëllohet me gungën e shkopit nxjerr gjësim të rëndë, ndërsa me thupër lëshon kumbim të hollë e të kthjellët. Gërshetimi i theksimeve me dorë të djathtë dhe të majtë arrin efekte metro-ritmike, dinamike, që pasurohen me “krisma të thata” goditje në trup, duke u zgjeruar mundësitë timbrike. Përdoret solo, kur ua mban ritmin valltarëve, por edhe me surle. Ka shërbyer edhe si zëdhënese për tubime në kuvende, në kremte apo paralajmërime rreziqesh. (Zeqirja Ballata)

VEGETACIONI. Shfaqet në formë pyjesh ose si tip barishtor. Pyjet u përkasin zonave të ndryshme të vegetacionit: zonës së dushkut, ahut, pyjeve të përziera, haloreve. Në terrenet kodrinore të Kosovës (400-900 m) janë të përhapura pyjet me shpërdarje qarr, mjaft të degraduara. Katin e drunjve dhe shkurreve e përbëjnë: shpërdarja, qarri, bungëbuta, bungu, frashri i bardhë, vadha, krekëza, thana, murrizi, ulza, kulumbria. Shtresën barishtore e përbëjnë elemente të ndryshme floristike. Në tokat më të freskëta (800-1,000 m) shtrihet pylli me bung, vende-vende i ruajtur mirë. Për nga përbërja floristike mbizotëron bungu, qarri, bliri, panja e malit, vadha, shkoza e bardhë, lajthia e egër, dardha e egër dhe ulza. Në Kosovë janë të pakta sipërfaqet e pyllit të bulgërit në lartësi 400-900 m. Kryesisht në terrene shkëmbore e të nxehta 400-800 m janë të përhapura shkurret me shkozë të zezë, të përziera me shumë shkurre të tjera. Në tokat serpentimore, në malet e Zatriqit në rrethinën e Rahovecit si dhe në rrethinën e Gjakovës (Ponoshec, Mulliq, Junik, Morinë) janë të përhapura shkurret me

boshtër. Në këto shkurre janë të pranishme mjaft lloje endemike e endemorelikte. Në relacionin ndërmjet Pejës e Gjakovës si dhe në rrethinën e Prizrenit janë të përhapura pyjet me gështenjën e butë të thjeshta ose të përziera që kanë tiparet e vegetacionit submesdhetar. Në lugina të freskëta e shpate të kthyer kah veriu në lartësi 600-900 m janë të pranishme pyjet e shkozës së bardhë dhe bungut, të përziera me lloje të tjera drunore e shkurre. Në kushtet e ngjashme ekologjike është i përhapur edhe pylli me ahun kodrinor. Në lartësitë mbidetare 900-1,300 m shtrihet zona e pyjeve të ahut malor. Mbizotërues është ahu e më pak shkoza e bardhë, bungu, panja e malit, mëlleza dhe vadha. Mbi pyje të ahut malor ndodhen pyjet e përziera gjethegjera e halore, në lartësi mbidetare 1,200-1,500 m, të përbëra nga ahu, bredhi, hormoçi dhe panja e malit. Mbi brezin e pyjeve të përziera shtrihen pyjet me bredh e hormoç, të përhapura kryesisht në malet larta të Kosovës në lartësi 1,500-1,700 m, ku përbërësit kryesorë janë bredhi dhe hormoçi. Në Alpet Shqiptare, në malet e Sharrit, në lartësi 1,400-2,000 m janë të përhapura arnishtat, të përbëra nga arneni i bardhë dhe arneni Heldreichit, dy lloje endemike dhe relikte. Kufirin e fundit të vegetacionit pyjor e formojnë shkurret e çetinakut të përhapura në zonën subalpine e alpine, në lartësinë mbidetare 1,800-2,200 m, mbi të cilën shtrihet zona e kullotave alpine. Në tipin barishtor të vegetacionit bën pjesë vegetacioni i livadheve ultësinore, barojave të kulturave bujqësore, kullotave dhe livadheve kodrinore, shkëmbinjve, kullotave të zonës alpine. Vegetacionin e tipit barishtor e përbëjnë kryesisht llojet e familjeve: kaptinore, gramore, fluturore, kryqore, buzore, ombrellore, zhabinore, piperore, zambakore, trëndafilore, salepore, boraginore, kambanore, llobatore dhe qumështore. Janë përshkruar shumë bashkësi bimore të këtij tipi të vegetacionit, duke filluar nga livadhet ultësinore e deri te zona e kullotave alpine. (Feriz Krasniqi)

VEKU (vegja, avlëmend, tezgjahu). Vegël tradicionale e punës, që shërbente për të endur pëlhura të ndryshme ose qilima. Në krahina të ndryshme shqiptare njihet me emra të ndryshëm, si: vegël, veg ose vek, avlëmend, tezgjah, tullar, argali etj. Me endje siguroheshin të gjitha nevojat për veshjen e anëtarëve të familjes, si dhe shtroja e mbuloja

e shtëpisë (qilimi, cerga, sexhadja, jani, plafa të ndryshëm etj.). Ishte ndër të parat mjeshtri që u përdor në jetën familjare dhe ndër më të rëndësishmit për funksionin që kryente. Pjesë të vekut janë: bollëzat, kamat, trarët, dërrasa e vekut (shkami), ku ulet vektorja gjatë punës; shuli i përparmë dhe shuli i mbramë, ku mbështillet pëlhura e punuar me fijet e tjerit; shpata e përbërë nga dhëmbët dhe bërtilat që shërbejnë për të ngjeshur fijet e “init”; liqtë që përcaktojnë teknikën e punimit (janë dy ose katër të tillë); ndërskamzat në trajtën e pedaleve, që ndërrojnë lisat; drugëza e vekut, me të cilën mbështillen fijet e init. Në Kosovë veku ka pasur një traditë të gjatë dhe mjaft të përhapur. (Angjelina Hamza)

VELA Agim (1951-). Mjek, anatomist, profesor universiteti. Lindi në Tetovë, shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në vendlindje, ndërsa studimet në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë (1974).



AGIM VELA

Gjatë studimeve u angazhua si demonstrator në Institutin e Anatomisë dhe, pas përfundimit të studimeve, u zgjodh asistent (1976). Vijoi studimet pasuniversitare në Fakultetin e Mjekësisë në Beograd, ku mbrojti edhe tezën e magistraturës.

Mbrojti disertacionin e doktoratës më 1981 në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë, më pas u emërua docent, profesor inordinar dhe më 1993 merr titullin profesor ordinar i lëndës së anatomisë. Ishte udhëheqës i programit të studimeve pasuniversitare në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë (2000-2002) dhe profesor në Fakultetin e Shkencave Mjekësore në Tetovë. Kreu detyra të tjera me përgjegjësi në Universitetin e Tetovës. Ka marrë pjesë në shumë kongrese e simpoziume ndërkombëtare dhe ka publikuar një sërë punimesh shkencore dhe profesionale, si autor dhe bashkautor. Gjithashtu, ka botuar tekste universitare nga fusha e anatomisë dhe disa dispensa shkollore për studentët e Fakultetit të Mjekësisë. Është profesor i rregullt në Institutin e Anatomisë në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. (Bajram Nuraj)

VELA Rifat (1926-2007). Veprimtar i arsimit. Lindi në Gajre të Tetovës, shkollën fillore e kreu në Tetovë, normalen në Prishtinë.

Studioi gjeografinë, pastaj edhe drejtësinë në Universitetin e Shkupit. Ishte mësues në disa fshatra të Tetovës, anëtar i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë (1962-1966), zëvendës-sekretar i Fondit për Arsim të Maqedonisë (1970-1974), si dhe kreu funksione të ndryshme në komunën e Tetovës, duke përfunduar detyrën e përgjegjësit për arsimin për rrethin e kësaj komune. Kontribuoi për ngritjen e arsimit shqip në Maqedoni. (Hatixhe Vojka-Ismajli)

VELANIA. Toponim vendbanimi, i shënuar në veprat e autorëve antikë dhe i vendosur në afërsi të Ulpianës antike. Ptolemeu e përmend i pari me emrin Vellanis në veprën “Gjeografia” (shek. II). Si Beclano (Veclanum) është shënuar nga Anonimi i Ravenës në veprën “Kosmografia” (shek. VII). Në bazë të gërmimeve arkeologjike supozohet se vendbanimi gjendej midis lagjes Tauk Bahçe të Prishtinës dhe hyrjes në malin e Gërmisë. (Pleurat Kabashi)

VELETINI. Fortifikatë parahistorike, antike dhe mesjetare. Ngrihet mbi Janjevë dhe sipër fshatit Shashkoc, në juglindje të Prishtinës, rreth 5 km në juglindje të Ulpianës antike. U ndërtua mbi një kodër të lartë (969 m), e cila ka sedimente të padepërtueshme shkëmbore në veri dhe verilindje, ndërsa anët e tjera, ndonëse mjaft të rrëpirëta, janë të kapërcyeshme. Me pozitë tejet të volitshme gjeostrategjike dominon gati në gjithë Rrafshin e Kosovës. Ka trajtë poligonale të parregullt, me tri tarraca dhe mure rrethuese, të cilat e përcjellin topografinë e relievit dhe e ndajnë fortifikatën në atë të epërme, të mesme dhe të poshtme. Përparoi falë rajonit të pasur me xehe, sidomos me argjend.

Kodra e Veletinit u banua për herë të parë në epokën e eneolitit (kultura Bubanj-Hum) dhe në të jeta vazhdoi gjatë gjithë epokës së hekurit, në antikë dhe në mesjetë. Shtresat kulturore të epokës së eneolitit dhe të epokës së hekurit janë dëmtuar mjaft, për shkak të ndërtimeve gjatë periudhës antike dhe mesjetës. Muret e ngritura në tarraca kanë gjerësi prej 2.40 m. Shtresat kulturore në rrëzat jugore dëshmojnë zgjerimin e vendbanimit në drejtim të rrafshit në shek. VI-V p.e.r. (faza paraurbane dardane) dhe hyrjen në përdorim të tullave elipsoide. Qeramika e stilit me figura të zeza dëshmon kontaktet me Atikën e Greqisë antike (VI p.e.r.)

dhe, pos tjerash, bashkë me fibulën harkore prej bronzi me kokë në trajtë palmete të stilizuar dhe aplikacione diskoide (V-IV p.e.r.) flasin për kontaktet dhe nivelin e lartë jetësor në të. Qyteti vazhdoi jetën gjatë periudhës bizantine dhe më pas, gjithnjë falë pasurive me metale të çmuara. Në të janë gjetur monedha të periudhave të ndryshme, nga ato të Damastionit (shek. IV p.e.r.) e të Durrahut dhe deri te monedhat e perandorëve të Bizantit, Teodosit (shek. IV), të Vasilit II (X-XI) e më pas. Ekzistojnë edhe themele të shumta të kishave të periudhave të ndryshme. Përmendet në Kartën e mbretit serb Milutin (1321) dhe në rregullat e veçanta të Sulltan Bajazitit II për punët organizative të minierave të argjendit të Janjevës (1488), ndërsa në Atlasin e V. M. Coronell-it figuron si gërmadhë (1689).

Mbështetur në madhësinë dhe pozitën e fortifikatës në afërsi të Ulpianës antike, mund të supozohet se Veletini është qyteti Justinopol. Tentime për ubifikimin e Justinopolit ka pasur kaherë dhe këto kanë qenë të ndërlidhura me ubifikimin e vetë Ulpianës, të ringritur pas tërmetit të vitit 518 nga perandori bizantin, Justiniani, i cili dhe ia dha emrin e ri Justiniana Secunda. Fakti se Prokopi i Cezaresë shkruan se Justiniani “themeloi një qytet tjetër fqinj që e quajti Justinopol, me emrin e ungjit të tij”, duke mos cekur se ishte në rrafsh apo në kodër, lindi edhe teza se Justinopoli u ndërtua ngjitur me Justiniana Secundën. Ka më shumë gjasa që fortifikata masive e Veletinit, bashkë me strukturat edhe nën të, të ketë qenë vetë qyteti i Justinopolit, i denjë për emrin e Justinin, xhaxhait të Justinianit, nga i cili e trashëgoi fronin. Me këtë shpërfaqet edhe rëndësia dhe roli i Justinopolit, të vendosur në arealin e minierave të çmuara dhe në pozitë mbrojtëse e mbikëqyrëse të vetë qytetit të Justinianit, të Justiniana Secunda, si dhe me mundësinë e strehimit të banorëve të saj. Gërmimet arkeologjike u zhvilluan nga Universiteti i Prishtinës (1988). (Edi Shukriu)

VELEZHA. Fshat në komunën e Prizrenit, 8 km nga qendra, në lartësinë mbidetare 380 m. Është vendbanim fushor i tipit të dendur me sipërfaqe 2.6 km². Si vendbanim me emrin Velje është i regjistruar në defterin e sanxhakut të Prizrenit të vitit 1530. Me të njëjtin emër figuron edhe në sallnamet e vilajetit të Kosovës të viteve 1893, 1896 dhe 1900. Një numër i

konsiderueshëm i popullsisë së fshatit emigroi brenda dhe jashtë Kosovës. Megjithatë, për shkak të shtimit natyror popullsia vazhdoi të rritet brenda periudhës 1948-2011. Derisa në vitin 1948 kishte 197 banorë, në regjistrimin e fundit (2011) kishte 460 banorë. Popullsia merret me lavërtari, pemëtari, vreshtari dhe blegtori. Një pjesë e konsiderueshme e popullsisë së fshatit varet nga dërgesat e emigrantëve. Ka shkollën 9-vjeçare, shkollën e mesme, shtëpinë e shëndetit, disa dyqane tregtare, kishën e Shën Nikollës dhe klubin e futbollit “Drita”. (Hasim Kryeziu)


VELIU Fazli (1945-). Veprimtar i çështjes kombëtare, kryeredaktor i gazetës “Zëri i Kosovës”, kryetar i LPRK-së (LPK). Lindi në fshatin Kollarë të Kërçovës. Kreu shkollimin e



FAZLI VELIU

mesëm në Tetovë. Punoi si mësues në shkollën fillore të Kollares dhe në tetëvjeçaren e Zajazit. Aktivitetin politik e filloi më 1968, me ngritjen e flamurit kombëtar në postkomandën e policisë dhe në shkollën e Zajazit. Në vitin 1978 shkoi në Zvicër, ku bashkëveproi me aktivistë të tjerë në kuadër të Lëvizjes për Republikën Socialiste Shqiptare në Jugosllavi (LRSHJ), pastaj të Lëvizjes Popullore për Republikën e Kosovës (LPRK) dhe Lëvizjen Popullore të Kosovës (LPK). Pas vrasjes së Jusuf Grëvallës, së bashku me disa veprimtarë vazhdoi botimin e gazetës “Zëri i Kosovës”, duke u bërë edhe kryeredaktor i saj. Në pranverë të vitit 1987 u zgjodh kryetar i LPRK-së, pastaj i LPK-së, detyrë që e kreu deri në vitin 1998. Ishte bashkëthemelues i Fondit “Vendlindja thërret”, bashkëthemelues i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare. Pas Marrëveshjes së Ohrit u zgjodh në udhëheqjen e Bashkimit Demokratik për Integrim dhe deputet i kësaj partie. Formoi Shoqatën e Veteranëve të Luftës të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare dhe u zgjodh kryetar i saj. Botoi shumë shkrime në shtypin ilegal, në “Zërin e Kosovës”, pastaj përmbledhje poezish, ditar luftime etj. (Fehari Ramadani)

VELIU Shevqet (1913-1983). Mësimdhënës veteran, veprimtar i arsimit. Lindi në Prizren, shkollën fillore e kreu në Krumë, gjimnazin-



SHEVQET VELIU

edhe drejtor i Gjymnazit Shqiptar në Prizren, pastaj instruktor i shkollave shqipe në rrethin e Prishtinës dhe të Podujevës. Për shumë vjet ishte mësimdhënës në Normalen e Prishtinës, drejtor i shkollës fillore (eksperimentale) “Branisllav Nushiç” në Prishtinë, si dhe sekretar i Dhomës Arsimore-Kulturore të Kuvendit të Kosovës. Sh. Veliu ishte autor dhe bashkautor tekstesh shkollore, i librave të leximit, të aritmetikës etj. Është bashkautor i librit “Fjaluer terminologjik serbokroatisht-shqip” (1961). Për punën e tij në arsimori lëvdata dhe mirënjohje. (Afërdita Deva-Zuna)

VELIU Veli (1958-). Shkrimtar, gazetar. Lindi në Muhoc të Bujanocit, kur kreu edhe shkollën fillore. Shkollën e mesme e kreu në Bujanoc, kurse studimet universitare në Prishtinë. Disa vjet punoi si arsimtar në vendlindje, kurse nga viti 1985 si gazetar në gazetën e përditshme “Rilindja”, ku redaktoi edhe faqen për fëmijë. Pas mbylljes së “Rilindjes” punoi në Bibliotekën rajonale “Hivzi Sulejmani” të Prishtinës, në të cilën, përveç tjerash, nxiti ndjenjën për lexim dhe shkrim letrar të lexuesit e vegjël. Më pas kaloi me punë si lektor në Kuvendin e Kosovës. U mor më tepër me letërsi për fëmijë, kryesisht me poezi, por botoi edhe libra me pjesë teatrale dhe me drama për të rritur. Veprat e botuara: “Zogj, merrmëni me vete” (1982), “Në strehën e yjeve” (1986), “Ditari i Zana Frangut” (1991), “Shtatë përralla” (1996) “Ana e Drinit të Bardhë” (1998), “Princi i këngës shqipe” (2000) etj. (Arif Demolli)

VELIU-VUÇITËRNA Valdeta (1970-). Grafiste. Lindi në Gostivar. Kreu Shkollën e mesme, Fakultetin e Arteve, drejtimi i grafikës, në Prishtinë (1991). Nga viti 2002 është mësimdhënëse e grafikës në Fakultetin e Arteve në Prishtinë. Krijimtaria e saj bazohet në rrafshin klasik të shtypit të thellë dhe në grafikën autoriale të sajua me tekstura të

degën normale në Shkodër. Në periudhën 1933-1941 ishte mësues në vise të ndryshme të Shqipërisë. Në vitin 1941 kthehet si mësues, përkatësisht drejtor shkollë në Prizren, ku vazhdoi edhe pas Luftës së Dytë Botërore. Ishte gjithashtu

ndryshme, që shprehin qasje meditative urbane e tradicionale, të sublimuara në kolorit të moderuar. Organizoi disa ekspozita personale: më 2005 e 2008 në Galerinë e Ministrisë së Kulturës në Prishtinë, më 2005 në Pallatin e Rinisë “ASNOM” në Gostivar, më 2008 në “Galerinë Nacionale” në Shkup, pastaj më 2012 në Galerinë e Arteve të Kosovës në Prishtinë. Mori pjesë në disa ekspozita të përbashkëta, si në “Arti bashkëkohor i Kosovës dhe i Austrisë” në Prishtinë, pastaj në Bienalen e Vizatimit në Melburn (Australi), në ekspozitën “Grafika e vogël” në Cadaques (Spanjë), në Bienalen e Grafikës së vogël “Inter-Art” në Aiud (Rumani), në Bienalen e Grafikës në Çeki, në ekspozitën “Çmimi Muslim Mulliqi” në Prishtinë, në Bienalen V e VI të grafikës Douro (Poloni) në Trienalen e Grafikës në Varshavë etj. Është fituese e disa çmimeve: “Salloni i Nëntorit”, “Dita e Prishtinës”, “Salloni Grand-Prix” në Belgjikë etj. (Fatmir Krypa)

VENDBANIMI ANTIK I ÇIFLLAKUT. Vendbanim i periudhës romake të fshati Çifllak, në të djathtë të rrjedhjes së Drinit të Bardhë. Është gërmuar një pjesë e vendbanimit (insula), e përbërë nga banesa dhe një termë dhe janë konstatuar fazat e banimit të shek. I-II dhe III-IV. Faza e dytë e ndërtimit ka cilësi më të lartë dhe spikatet me përdorim të afreskut në dekorimin e enterierit, shtrojës hidroizoluese të dyshemesë dhe mureve të ngrehura me teknikë opus mixtum. Terma ka apsidë gjysmëharkore të rregullt, të ndërtuar me teknikë opus incertum dhe opus mixtum dhe dysheme në ambientin qendror të punuar me teknikë opus reticulatum (kapërcyell i shek. II-III). Sipas gjurmëve të djegies, jeta në vendbanim përfundoi në fillim të shek. V. Vendbanimi ishte një e rëndësishme e komunikimit rrugor, mbase përgjatë trasesë Lissus-Naissus. Në afërsi janë gjetur objekte të periudhës neolitike (Sarosh, Ratkoc), si dhe fragmente arkitektonike, stela dhe altarë të shek. II-III. Jo larg ndodhen fortifikime të shek. III-IV dhe VI, si Guri i Kuq, Zatriqi (Rahovec), Dollci (Klinë) dhe Cërmjani (Gjakovë). (Luan Perzhita)

VENDBANIMI ANTIK I DOBROTINIT. Vendbanim i periudhës romake afër Ulpianës (Lipjan). Mbështetur në gjetjet e deritanishme, duket se është një vendbanim fshati, i tipit *vicus*.

Në mesin e gjetjeve të shumta gjatë punimeve bujqësore në të veçohen ato të vitit 1961, kur u zbulua një thesar me rreth 6,000 monedha dhe disa llamba të çmuara prej bronzi. Objektet u zbuluan nën rrënojat e një objekti, që duket të kishte qenë një villa rustica. (Arben Hajdari)

VENDBANIMI ANTIK I NIKADINIT. Vendbanim rrafshinor i periudhës romake te Nikadini i Ferizajt. U njoh pas gjetjes së rastit të kapakut të një sarkofagu nga guri trahit-andezit (108 x 45(57) x 40-44 cm) dhe të blloqeve të gurëve, nga i njëjti gur (2005). Në vitin 2007 Instituti Arkeologjik i Kosovës zhvilloi gjurmime sondazhi, me çrast u gjetën pjesë të një sarkofagu më të vogël me dekorime vegjetale dhe gjurmë të kishës së krishterimit të hershëm (shek. IV-VI), të plotësuar me disa spolje të plastikës dekorative sepulkrale të periudhës romake (shek. III-IV). Nga sarkofagu i parë ka mbetur vetëm kapaku i tipit çati në dy ujëra, që është trajtë më e shpeshtë në Dardani. Më mirë është ruajtur faqja e djathtë anësore, e zbukuruar me motive bimore. Në frontonin trekëndësh është skalitur një rozetë në mes, me nga një gjethe akanthi në të dyja anët, kurse akroterët e mëdhenj në trajtë kallote janë dekoruar me motive gjysmëpalmetash, të cilat gjenden dhe në anën tjetër të akroterit të djathtë. Është karakteristike se në akroterin e majtë të anës së parme është ruajtur koka e mashkullit me kapelë frigjiase dhe me kornizë nën të, që duket se janë gjurmët e një shkronje, ndërsa e njëjta kokë duhej të ishte dhe në akroterin tjetër të anës së parme të kapakut. Paraqitja e tillë del e veçantë në Mezinë e Epërme.

Identiteti i saktë i kokës së paraqitur është vështirë të përcaktohet, ndonëse portreti i skalitur në profil ka ikonografi të qartë. Kapela frigjiase tregon se është fjala për një figurë orientale, por nuk është e qartë se a është paraqitur një person nga mitologjia apo i ndjeri. Identifikimi me perëndinë frigjiase, Atisin, nuk është i sigurt, aq më tepër kur kihet parasysh fizionomia serioze dhe e zymtë e portretit, andaj supozohet se është fjala për vetë të ndjerin. Duket se sarkofagu është punuar në një punëtori lokale, sipas modeleve të Azisë së Vogël, ku janë skalitur edhe portretet e të ndjerëve. Para së gjithash, mund të jetë punuar në punëtorinë e Scupit gjatë shek. III nga dora e një mjeshtri shëtitës, i cili duhet të ishte po ashtu nga Lindja. Nga kjo

trëvë ishte edhe i ndjeri, si ushtarak apo civil i ardhur, i cili mund të ketë qenë edhe adhures i kultit metroak (Nënës së Madhe). Gjetja e dy sarkofagëve dhe e blloqeve të gurëve me material të njëjtë si sarkofagët, tregon se është fjala për lokalitet të rëndësishëm të antikës. (Exhlale Dobruna-Salihu)

VENDBANIMI ANTIK I ZLLAKUQANIT. Vendbanim i periudhës romake. Gjetet në Zllakuçan të Klinës, në arealin e kishës katolike. Si lokalitet arkeologjik u identifikua nga E. Shukriu në vitin 1994, por u dëmtua në masë me ndërtimin e pishinës dhe të restorantit në Kosovën e pasluftës. Në të është konstatuar ekzistimi i një tempulli të madh të shek. I-II të termave tejet luksoze dhe gjurmë të ndërtimeve të tjera. Po ashtu janë gjetur disa monumente votive, në mesin e tyre kishte që i kushtoheshin hyjneshës egjiptiane Izida. Në areal ka dhe gjurmë të vazhdimësisë së jetës dhe gjatë mesjetës, ndërsa rëndësinë e këtij lokaliteti edhe si hapësirë kulturi e dëshmon prezenca në vazhdimësi e kishës katolike. (Pleurat Kabashi).

VENDBANIMI PARAHISTORIK I BARDHOSHIT. Vendbanim rrafshinor i epokës së neolitit të vonë (4000-3500 p.e.r.). Gjetet në Bardhosh, rreth 4 km në veri të Prishtinës, në krahun e majtë të magjistrales Prishtinë-Podujevë. U identifikua rastësisht në vitin 2002, gjatë hapjes së themeleve për ndërtimin e një shtëpie. Vendbanimi zë një sipërfaqe prej rreth 1ha. Muzeu i Kosovës zhvilloi gjurmime arkeologjike me karakter shpëtimi po atë vit dhe zbuloi disa ambiente banimi me vatër dhe vegla pune e enë qeramike. Vlerë të veçantë paraqet gjetja e numrit të madh të terakotave antropomorfe me madhësi të ndryshme, disa për nga forma të ngjashme me "Hyjneshën në Fron". U zbulua dhe një kentaur prej balte të pjekur, si dhe modele furrash në miniaturë. (Kemajl Luci)

VENDBANIMI PARAHISTORIK I BARI-LEVËS. Vendbanim fushor shumështrësor i kulturës së Starçevës (neoliti i hershëm dhe i mesëm) dhe i kulturës së Vinçës (neoliti i vonë dhe eneoliti i hershëm). Ndodhet në vendin e quajtur "Arat e Kovaçevë", në anën e majtë të luginës së lumit Llap. Përfshin sipërfaqen prej 5-6 ha. Në të janë zbuluar figura antropomorfe, gjurmë banesash, enë

të qeramikës të përdorimit të përditshëm dhe vegla pune nga ashti e stralli. Nga ky lokalitet u bë e njohur “Figurina e Barilevës”, botuar nga kustosja e Muzeut të Kosovës, N. Gjuriq. (Haxhi Mehmetaj)

VENDBANIMI PARAHISTORIK I GLLANDNICËS. Vendbanim fushor i neolitit të hershëm dhe të mesëm (kultura e Starçevës). Zë sipërfaqe afro 5 ha. Ngrihej në të dy anët e përroit Graçankë në Graçanicë. Shtresat kulturore (3 m) janë përfaqësuar në katër horizonte banimi, në të cilat janë konstatuar gjurmë të shtëpive të ngritura mbi themele të veçanta gurësh. Muret janë suvatuar me baltë të përzier me byk dhe janë hijeshuar me motive gjeometrike dhe motive figurash. Janë zbuluar altarë kulti me recipient katror, figura antropomorfe, figura zoomorfe nga argjila dhe qeramika neolitike. Veçohet figura unikate e hyjneshës nga argjila e neolitit të hershëm, që është figura më e hershme e zbuluar në Kosovë. Ka formë cilindrike, flokë të krehura dhe gjinj të bëshëm. Është e tejshpuar vertikalisht dhe është fiksuar për vatër të zjarrit. Në lokalitet janë konstatuar edhe shtresa banimi të epokës së bronzit dhe hekurit. U gërmua nga Muzeu i Kosovës (1973). (Haxhi Mehmetaj)

VENDBANIMI PARAHISTORIK I RESHTANIT. Vendbanim i epokës së neolitit. Nndodhet në krahun e djathtë të lumit Topluha të Reshtanit të Suharekës. Gërmimet e para



NGA GËRMIMET ARKEOLOGJIKE NË RESHTAN

u zhvilluan në vitin 1963, që pasuan nga gërmimet sistematike në sipërfaqe prej 288 m² në vitet 1966-1967. Në vitin 2010 u bë prospeksioni gjeomagnetik nga ekipi gjerman dhe një gërmim sondazhi (3 x 3 m). Gërmimet

me karakter shpëtimi nisën në vitin 2011, të kushtëzuara nga zgjerimi i rrugës Suharekë-Rahovec. Shtresa kulturore ka thellësi deri në 2.70 m dhe në të janë fiksuar 3 horizonte banimi: Reshtni I, II dhe III. Reshtani I i takon neolitit të vonë (Vinça-Tordosh I, II), ndërsa Reshtani II, me horizontet 2 dhe 3, është formuar nga bashkëjetesa e përbërëses së fuqishme danilike të vonë (Danilo III-IV) dhe fazës së hershme Hvar I-Lisiçiq të neolitit të vonë dalmatin dhe të asaj të Vinçës së vonë (Vinça-Ploçnik), që paraqitet më e dobët. Në Reshtani I ka banesa gjysmë të nëndheshme, me planimetri ovale (3 x 3 m), dyshme argjilore, shpesh të djegura e të shtruara mbi një platformë gurësh të vegjël zallorë, rrallë të plotësuar me fragmente enësh. Me këtë horizont është e lidhur dukuria kultike e sakrifkimit të buajve dhe vendosjes së bukranioneve nën tabanin e dyshemeve të banesave, në funksion të mbrojtjes së shtëpisë dhe banorëve nga fatkeqësitë e ndryshme. Është e para herë që bukranioni gjendet “in situ” në Kosovë. Në Ballkanin Juglindor janë ndeshur vetëm dy raste, ku bukranioni është modeluar prej argjile (Dikili Tash të Maqedonisë Lindore dhe në Promachion-Topolnica afër Dikili-Tashit). I njëjti koncept njihet edhe në vendbanimin neolitik të Çatalhyjikut të Anadollisë, ku kokat e buallit prej gjipsi të bardhë janë vendosur në dyshme dhe në muret e kthinave të konsideruara si tempuj. Qeramika e kësaj faze karakterizohet me kupa gjysmësferike e bikonike, tava konike, tasa etj., me zbukurime me barbotin me breza vertikale me relief të lehtë (karakteristikë për fazën e hershme të Vinçës), zbukurime plastike me thimtha e pulla sferike, kanelyra etj. Reshtani II përfaqëson një simbiozë kulturore midis kulturës së Danilos dhe asaj të Vinçës, me mbizotërim të përbërësve të grupit danilik. Qeramika e kësaj faze karakterizohet me incizime të trekëndëshave të mbushur në formë rrjete të tipit adriatikas, trekëndësha të mbushur me shpime, hullitë spiralike të tipit Hvar I etj. Inkrustimi i bardhë i motiveve të incizuara gjeometrike, me bazë trekëndëshat, rrjetën etj. është gati një rregull, ndërsa inkrustimi i kuq ndeshet rrallë, dukuri që është konstatuar edhe në Danilo III-IV (Dalmaci), Blaz III (Mat), Tërnska tumba (Pelagoni) etj. Reshtani përfshihet në zonën kulturore kalimtare nga Adriatiku në Ballkanin Qendror, që përfshin luginën e Drinit të Zi (pellgjet

e Dibrës e të Kukësit), pellgun e Ohrit e të Strugës, Pelagoninë Perëndimore dhe Rrafshin e Dukagjinit, elementet e paktë të së cilës arrijnë në lindje deri në Fushë-Kosovë (Tjerrtorë). Në këtë fazë kulturi është përfaqësuar nga shumë ritone dhe variantet e dekorimet e shumta të tyre, si objekte kulturi të pjellorisë së gjësë së gjallë. Këto kanë qenë të përhapura në gjithë arealin adriatik-mesdhetar (Danilo, Hvar-Lisiçiq, Obre I-II, Kakanj, Butmir, Vlashnjë I, Kolsh II, Topojan II, Cakran-Dunavec, Elatea, Greqi etj.). Duke pasur parasysh se Reshtani II i paraprindit Hisarit I dhe Vlashnjës I, mbarimi i fazës Reshtan II përputhet me fillimin e fazës Hisar I, që do të thotë se banorët e Reshtanit u zhvendosën në vendbanimin e Hisarit, që siguron mbrojtje të mirë natyrore ndaj sulmeve të turmave transhumane të kulturës indoeuropiane Bubanj-Hum I në drejtim të brendësisë së Rrafshit të Dukagjinit, në kërkim të tokave dhe kullotave të lira. Pas përfundimit të jetës në këtë vendbanim, banorët u vendosën në tarraca lumore me mbrojtje natyrore, më të përshtatshme në kushtet kur ardhja e turmave transhumante në kërkim të tokave bujqësore dhe kullotave të pashfrytëzuara kishte filluar të rrezikonte jetën e banorëve. Me këto depërtime përfundon jeta në Reshtan, për të vazhduar në Hisar I, ku bartësit e kulturës Bubanj-Hum I depërtuan në fillim të epokës eneolitike. (Shafi Gashi)

VENDBANIMI PARAHISTORIK I RUNIKUT. Vendbanim rrafshinor i epokës së neolitit. Ndodhet në Runik të Skënderajt dhe u gërmua nga Muzeu i Kosovës (1966-1984). Në të janë konstatuar 4 faza suksive neolitike. Runiku I është horizonti më i hershëm i epokës së neolitit në Kosovë, si lokaliteti i Glladnicës te Graçanica dhe Gjonaj-Tupeç te Prizreni, e cila i takon fazës së protostarçevës të Ballkanit Qendror. Karakterizohet nga qeramika monokrome e kuqe me lustër, barbotine dhe imresso. Runiku II, pjesë e kulturës së Starçevës, karakterizohet me shfaqjen e qeramikës fine monokrome me ngjyrë të kuqe dhe të dekoruar për herë të parë me ngjyrë të bardhë me motive lineare-geometrike, si dhe në Vlashnjë e Gjonaj të Prizrenit. Karakteristike për objektet e kultit janë sidomos figurinat antropomorfe dhe altarët prej argjile të pjekur. Runiku III, si pjesë e kulturës së Starçevës, karakterizohet me zhdukjen e qeramikës me ngjyrë të bardhë dhe

shfaqjen në masë të qeramikës monokrome fine, të dekoruar me motive lineare dhe kurbolineare me ngjyrë kafe. Runiku IV i takon dhe neolitit të vonë të kulturës së Vinçës, në të cilën nuk mungojnë terakotat e tipit "Hynjesha në fron". Runiku është vendbanimi më i veçantë i neolitit në Kosovë për nga shtrirja dhe për nga pasuria kulturore dhe përfaqëson vendbanimin më të mirë për studimin e grupeve kulturore neolitike. (Shafi Gashi)

VENDBANIMI PARAHISTORIK I VALLAÇIT. Vendbanim i epokës së neolitit të vonë. Vendbanimi zë hapësirë të vogël të një grope të shkëmbit të Vallaçit, në afërsi të Mitrovicës. Nga të tri anë mbrohet prej pengesave natyrore, nga shkëmbinj natyrorë e humnera dhe lumi i Ibrit. E vetmja qasje në jug ishte e fortifikuar me gardh druri (palisade) dhe mur të thatë të ngritur nga copa shkëmbinjsh. Këto elemente i japin vendbanimit karakter të një kështjelle, e veçojnë nga vendbanimet e tjera vinçiane të Anamoravës dhe të pellgut të Danubit të Poshtëm dhe dëshmojnë mbi rrethana të reja të jetës, të fillimit të përdorimit të metalit, por më shumë të depërtimit të valëve indoeuropiane. Për këtë, lokaliteti veçohet me pozitën specifike dhe jo të zakonshme në kuadër të kulturës vinçiane, me plastikën jashtëzakonisht të pasur dhe me ngjyra lokale të materialit në qeramikë. Një pjesë e qeramikës vinçiane tregon tendencën e formimit të një stili të ri dekorativ, i cili mund të lidhet me ngjarjet kulturore në pellgun e Moravës, në Bullgarinë Jugore dhe Maqedoni, në kohën e kalimit për në periudhën e metalit. Kështu, materiali jovinçian në Vallaç paraqet analogji me vendbanimet e grupit Bubanj-Hum eneolitik (Bubanj Hum Ib ose më herët) dhe të Bullgarisë (Veselinovo-Sveti Kirilovo). Në aspektin kronologjik, Vallaçi përkon me Vinçën e vonë dhe fazën më të hershme të Bubanj-Humit. (Shafi Gashi)

VENDBANIMI PARAHISTORIK I ZHITKOCIT. Vendbanim parahistorik i epokës së neolitit. Gjendet në tarracën lumore të krahut të djathtë të lumit Ibër te fshati Zhitkoc, rreth 3 km në veri të Zveçanit. U zbulua gjatë hapjes së trasesë hekurudhore për në Mitrovicë (1955) dhe Zhitkoci e Karagaçi janë i njëjti vendbanim, që u nda nga transheja e hekurudhës. Jo larg në jug gjendet dhe vendbanimi neolitik i Vallaçit. Gërmimet arkeologjike u zhvilluan

në vitin 1958 dhe u konstatua ekzistimi i dy fazave të banimit: Zhitkoc I (neoliti i hershëm: Starçevë IIb), Zhitkoc II (neoliti i vonë: Vinça-Tordosh) dhe Zhitkoc III (bronzi i hershëm). Zhitkoci I kishte kasolle në trajtë elipsoide, gjysmë të groposura dhe të mbrojtura me hendeqe. Përfaqësohet nga qeramika monokrome e pikturuar dhe e latuar me forma të rrumbullakuara, por ka dhe enë konike me këmbë të lartë trung-konike golle përbrenda. Qeramika barbotine me ngjyrë të kuqe tulle shoqërohet dhe me shirita plastikë të impresionuar mbi supe, që kufizonte pjesën e poshtme të enës me të sipërmen e rrafshët. Është i pranishëm edhe barbotini me sprucim të lehtë, të organizuar me vaska të cekta. Fazës Zhitkoc II i takojnë shtëpitë e punuara nga thupra të gërshetuara dhe të lyera me baltë, të ngritura mbi kulturën paraprake. Qeramika përcjell trajtat dhe dekorimin e fazës së hershme Vinça-Tordosh të kulturës së Vinçës, si dhe në Fafos Ia, Karagaç dhe në breg të lumit Lushtë në periferi të Mitrovicës etj. Zhitkoc III ka shtresa me elemente të qeramikës postneolitike, që gjenden të përziera edhe me shtresën neolitike. Në të ka elemente të reja kulturore: filxhana me një vegjë që ngrihet mbi buzë, të ngjashëm me ato të Maliqit IIIa dhe që lidhen me bronzin e hershëm maqedon (faza III) sipas kronologjisë egjeane. Ka mundësi që të jenë materiale varresh me ndërhyrje në këtë shtresë. (Shafi Gashi)

VENDBURIMET E BENTONITEVE. Në Basenin terciar të Kamenicës, të Vitisë dhe të Gjilanit janë të njohura shumë shfaqje të bentoniteve. Por me interes të veçantë janë Karaçeva, Gushterica dhe Sadovina e Jerlive. Vendburimi i bentonit të Karaçevës ndodhet afër atij të kaolinit, që ka këto përmasa: gjatësia e shtresës 400 m, trashësia mesatare 0.80 m, rezervat $B + C_1 = 1.5 \times 10^6$. Janë ndër më cilësoret në botë, me përmbajtjen mesatare 60.3% të SiO_2 . Bentonitet kanë përdorim të gjerë në industrinë e letrës, të gomës, të parfumerisë, në shpime të thella të naftës etj. Në fshatin Gushtericë të Vitisë është zbuluar vendburimi i bentonitit me dy shtresa, që kalojnë trashësinë prej 100 m, që është ndër vendburimet më të mëdha në botë. Shtresa e parë me ngjyrë të verdhë në të gjelbër ndodhet në thellësi 0.3-25 m dhe ka trashësi mesatare 12.3 m, ndërsa nën shtresën e parë ndodhet e dyta me trashësi

mestare 22.6 m, që ka ngjyrë gri-të kaltër. Trashësia mesatare e të dy shtresave deri në thellësi 50 m është 35 m. Bentoniti i Gushtericës është studiuar hollësisht, është plastik dhe nuk përmban rërë. Tavano që mbulon vendburimin ka trashësi 11 m, i ndërtuar nga argjila e kuqe. Rezerva të kategorisë C_1 gjenden në thellësi deri 50 m janë 23.6×10^6 t, kurse ato C_2 në thellësi deri në 100 m janë 50×10^6 t. Vendburimi ka kushte gjeologjike për nxjerrje nga sipërfaqja. Vendburimi Sadovina e Jerlive ndodhet 6 km në perëndim të Vitisë. Me studime është vërtetuar se bentoniti i këtij vendburimi ka cilësi më të dobët ose të ngjashëm me atë të Gushtericës. Gjithashtu ka kushte të mira për nxjerrjet nga sipërfaqja. Trashësia e shtresës së bentonitit është 8 m dhe po aq është edhe shtresa e tavanit. Rezervat e përgjithshme gjeologjike janë $A+B+C_1 = 6.15 \times 10^6$ t. (Minir Dushi)

VENDENISI. Vendbanim (oppidum) i periudhës romake dhe stacion rrugor i periudhës antike. Sipas Tabula Peutingeriana, ndodhet 60 milje larg nga Naisi në drejtim të Lisit (rreth 89 km). Vendbanimi shtrihet në prapatokën e bregut të djathtë të lumit Llap, rreth 5 km në juglindje të Podujevës dhe zë një sipërfaqe prej 15-20 ha. Incizimet gjeofizike të kryera së fundmi dëshmuar prezencën e një vendbanimi të fortifikuar dhe konstatuan se traseja e rrugës Lissus-Naisus kalonte përmes vendbanimit. Pas gërmimeve të viteve '80 të shek. XX është zbuluar material i pasur arkeologjik, një kompleks i ndërtesave (villae) me karakter banimi, ku spikatet mozaiku i dyshemesë së dekoruar me motive gjeometrike dhe shfaqja figurative e Orfeut të rrethuar me zogj, leopardë, luanë, gjarpërinj, pemë dhe me mbishkrimin "Orfeus" sipër kokës. (Emine Kalaja-Hajdari)

VENERA E VENDENISIT. Statuetë e hyjneshës Venera e periudhës romake. Është punuar në bronz dhe u gjet rastësisht në Gllamnik (Vendenisi antik), afër ndërtesës luksoze me mozaikun e Orfeut, inventar i së cilës mund të ketë qenë. Është ruajtur mirë (7.6 cm), por i mungon shputa e këmbës së djathtë me një pjesë deri te nyelli dhe shputa e këmbës së majtë. Hyjneshja është paraqitur lakuriq në çastin e rregullimit të flokëve dhe, si e tillë, paraqet njëri nga variantet e

shumta të Venerës lakuriqe, të punuara sipas Praksitelit dhe shkollës së tij. Trupi i saj, i kthyer lehtë nga e majta, qëndron mbi këmbën e majtë. Duart i ka të lakuara në bërryl dhe të ngritura. Me të majtën mban një tufë flokësh të përdredhur, kurse me të djathtën një pasqyrë predimensionale. Kokën e ka të kthyer në gjysmëprofil në drejtim të pasqyrës. Flokët, të krehur në valëzime të shpeshta rreth fytyrës, mbliidhen në një prapa në zverk, prej nga dy blej krelash bien mbi supë. Mbi flokë mban diademën e theksuar dukshëm, në trajtën e kurorës. Përkundër flokëve të modeluar mjaft mirë, detajet në fytyrë, edhe pse të theksuara, janë trajtuar thjeshtë me gravurim. Trupi është punuar mirë, me proporcione të harmonishme dhe me detaje anatomike të trajtuara natyrshëm në të dy anët. Statueta e Venerës në çastin e tualetit është ekzemplari i vetëm i zbuluar në Dardani. Është mjaft cilësore, e bërë sipas ndonjë modeli të mirë helenistik, në ndonjërin prej qendrave të njohura të punimit. Bazuar në figurinat e një pune të mirë provinciale dhe të importuara nga qendrat e tjera të perandorisë gjatë shek. II ose gjysmës së parë të shek. III, mendohet se edhe statueta i takon të njëjtës kohë. (Exhlale Dobruna-Salihu)

VENERA ME DY EROSË. Grup statujash të perëndeshës së bukurisë dhe dashurisë. Kompozicioni me dy Erosë, me gjasë i gjetur në Ulpianë, paraqet realizim skulpturor mjaft interesant. Është punuar në mermer të bardhë me përmasa mjaft të vogla, nga i cili sot ka mbetur vetëm gjysma e poshtme (14 x 14 x 2 cm). Grupin e përbëjnë tri figura të vendosura mbi një bazament katërkëndësh: perëndesha Venera në mes dhe dy Erosë në të dy anët e saj. Venera, nga e cila ka mbetur torzoja, është paraqitur nudo dhe me duar që mbulon pjesët intime. Kjo paraqitje i përgjigjet ikonografikisht tipit më të popullarizuar dhe të kopjuar shpesh të saj nudo, të quajtur “Pudica” (e turpshme). Tipi ka dalë nga skulptura e Praksitelit, skulptor grek i shek. IV p.e.r. Erosët janë paraqitur në pozicione të ndryshme dhe atij në të majtë i mungon koka. Erosi në anën e majtë i takon të ashtuquajturit “Erosi i pikëlluar” ose “Erosi i gjumit të përjetshëm”, që ka funksion funerar. Erosi në anën e djathtë është dhënë në pozicionin e ngasjes së delfinit. Ky pozicion i tij, i cili në Dardani paraqet rastin e vetëm, në tërë Perandorinë Romake njihet nga një numër

i caktuar shtatoresh të Afroditës apo Venerës (Venus Marine). Paraqitja ikonografike e grupit të statujave në tërësi ka ngjashmëri, me dallime të vogla, vetëm me ekzemplarin e punuar në mermer të Muzeut Kombëtar të Beogradit. Duket se bëhet fjalë për të njëjtin model të realizuar në variante, por vendi ku u punuan është vështirë të përcaktohet. Megjithatë, është e sigurt se ky grup statujash deri më sot paraqet një ekzemplar unik në Dardani. (Exhlale Dobruna-Salihu)

VENHARI Mustafa (1922-). Mësimdhënës veprimtar. Lindi në Vushtrri, ku kreu edhe shkollën fillore serbe. Kreu kursin pedagogjik (1943), si dhe Shkollën e Lartë Pedagogjike në Nish. Punën si mësues e filloi në vitin 1943, në shkollën fillore të Gojbulës, pastaj në Istok, Zallq, Vushtrri etj. U angazhua kundër regjistrimit të popullsisë shqiptare si turq, u inkuadrua në organizatën atdhetare “Lëvizja Nacional-Çlirimtare e Kosovës”, për çka u burgos dy herë, u pushua nga puna dhe u dërgua të punojë si mësues në Tërnoc të Madh të Bujanocit, në Muhoc dhe në Preshevë, pastaj edhe në Likovë të Maqedonisë. Më vonë u kthye në vendlindje dhe punoi në gjimnazin e Mitrovicës, prej nga sërish u pushua nga puna arsimore dhe u punësua në administratën e kombinatit “Trepça”. (Fahri Buçinca)


VERBICA Artan (1979-). Gazetar i sportit. Lindi në Prishtinë. Që nga viti 1995 filloi të shkruajë në forumin e portalit botëror “Wast Side Boxing”. Më pas shkrimet i botohen edhe në dy portalet botërore, “Fight-News” dhe “Boxing-Banter”. Në vitin 2007, së bashku me Luan Dreshajn, themeluan faqen e parë shqiptare të boksit “AlbanianBoxing.com” dhe pas dy vjetësh hapi faqen e tij të re “KosovaBoxing.org”, e cila në vitin 2013 u zgjerua edhe më shumë me revistën periodike “Kosova Boxing Magazine”. Njihet edhe si menaxher, që duke ndërmjetësuar në afro 30 meçe, u bë i njohur jo vetëm në Kosovë, por edhe në Mal të Zi, Francë, Zvicër, Poloni, Sllovaki, Gjermani, Azerbajxhan, Hungari, Suedi etj. Në vitin 2014, në kongresin botëror të mbajtur në Salvador (versioni WBA) u nderua me mirënjohje si ndërmjetës i shquar në organizimin dhe zhvillimin e boksit botëror. (Baki Berisha)

VERLI Marenglen (1951-). Historian, profesor. Lindi në Tiranë. Studimet e larta i kreu

MARENGLLEN
VERLI

në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë në Universitetin e Tiranës (1973). Prej vitit 1979 është punonjës shkencor në Institutin e Historisë të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, ndërsa nga viti 1981 punon edhe si pedagog i jashtëm në Universitetin e Tiranës. Në Institutin e Historisë ka mbajtur detyrat e përgjegjësit të departamentit të historisë së Kosovës dhe të drejtorit të Institutit të Historisë (2005-2008). Nga viti 2005 ishte kryeredaktor dhe nga viti 2008 zëvendëskryeredaktor i revistës "Studime historike", ndërsa gjatë viteve '90 ishte anëtar i redaksisë së revistës historiko-politike "Kosova". Në vitin 2009 u zgjodh akademik i asociuar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, ndërsa nga viti 2016 anëtar i rregullt i kësaj akademie. Është autor i shumë botimeve monografike për historinë e shqiptare në përgjithësi, përfshirë dhe historinë e Kosovës: "Reforma agrare kolonizuese në Kosovë 1918-1941" (1992), "Shfrytëzimi ekonomik i Kosovës në vitet '70-'90" (1994), "Ekonomia e Kosovës në vargonjtë e politikës jugosllave 1945-1990" (2000), "Nga Kosova për Kosovën (profile biografike)" (vëll. I, 2006), "Kosova, sfida shqiptare në historinë e një shekulli" (2007), "Shqipëria dhe Kosova - historia e një aspirate" (2007) etj. Ka përgatitur dhe disa vëllime me dokumente të zgjedhura e kujtime si: "Lidhja Shqiptare e Prizrenit në dokumentet austro-hungareze (1878)" (2008), "Shqipëria në dokumentet austro-hungareze 1912" (2012), "Shqipëria e viteve 1912-1964 në kujtimet e Spiro Kosovës" (2008), "Plava e Gucia në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare" (1995) etj. (Teki Kurti)

VESELAJ Nuhi (1933-). Gjuhëtar. Lindi në fshatin Reçan të Suharekës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, normalen në Gjakovë. Studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe i mbaroi në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës, ku kreu studimet pasuniversitare dhe mbrojti tezën e disertacionit (1992). Punoi si mësimdhënës në Mushtisht, Suharekë, Grejçec, më pas në Ferizaj, Tankosiq dhe Prishtinë. Është burgosur për motive politike nga regjimi jugosllav (1952). Po për motive politike më 1973 iu ndalua puna në arsim dhe



NUHI VESELAJ

në organizata shoqërore. Punoi si përkthyes, por edhe që andej e larguan dhe u pensionua para kohe. Botoi kryesisht vjersha dhe tregime për fëmijë: "Miklime" (1967), "Rrezet e ylber-ta" (1971), "Me buzë në gaz", (1997), "Trimoshi" (1997), "Cace e hope djaloshare" (1997), "Shfrime nëpër mjegullnajë" (1997), "Mësime nëpër pësime" (1998), "Bulëza të përshenjuara" (2000) etj. Nga fusha e gjuhësisë botoi: "Çështje të shqipes standarde në fushë të leksikut dhe të fjalëformimit" (1997), "Paskajorja, çështje e shqipes standarde" (2000), "Foljet me -o- në gjuhën shqipe" (2002), "Paskajorja dhe standardizimi i gjuhës shqipe" (2006). Botoi edhe disa monografi. (Bahri Koskoviku)

VESELI Abdylaziz (1942-2008). Pedagog, mësimdhënës universiteti, veprimtar i arsimit. Lindi në Gjiilan, ku kreu edhe shkollën fillore, semimaturën dhe gjimnazin. Studioi pedagogjinë në Fakultetin Filozofik të Shkupit, magjistroi në Fakultetin Pedagogjik të Universitetit të Rijekës (1978) dhe doktoroi më 1998 në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Filloi të punojë mësues në Gjiilan,



ABDYLAZIZ VESELI

pastaj mësimdhënës i lëndëve pedagogjike në Normalen e Gjiilanit, ku ishte edhe drejtor i saj. Punoi edhe në gjimnazin e Bujanocit, ishte drejtor i Entit Pedagogjik, përkatësisht sekretar i Sekretariatit për arsim, shkencë e kulturë në Gjiilan. Në vitin 1968 u zgjodh mësimdhënës i lëndëve pedagogjike në Shkollën e Lartë Pedagogjike (SHLP) të Prishtinës, pastaj në SHLP të Gjiilanit. Në periudhën 1997-2002 ishte mësimdhënës në Universitetin e Tetovës. Është autor artikujsh profesionalë-shkencorë, si dhe i disa veprave pedagogjike: "Metodika e njohjes së ambientit" (1987), "Pedagogjia parashkollore" (1999), "Shkolla dhe arsimit shqip në Maqedoni gjatë periudhës 1941-1944" (2000), "Shkolla dhe arsimit shqip në prefekturën e Prishtinës gjatë periudhës 1941-1944" (2003), "Shkolla dhe arsimit shqip në prefekturën e Prizrenit

gjatë periudhës 1941-1944” (2003), “Shkolla dhe arsimit shqip në prefekturën e Pejës gjatë periudhës 1941-1944” (2003) etj. (Januz Dervodeli)

VESELI Ahmet (1944). Fizikan, profesor universiteti. Lindi në Gjilan, shkollën fillore dhe Shkollën Normale i kreu në vendlindje, studimet e larta për fizikë në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës (1969). Disa vjet punoi mësimdhënës i gjimnazit në Gjilan dhe Prishtinë. Studimet pasuniversitare i kreu në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore (FSHMN) të Universitetit të Zagrebit (1977). Tezën e disertacionit e mbrojti në FSHMN të Universitetit të Prishtinës (1980). Është autor i teksteve universitare “Fizika për studentë të biologjisë” dhe “Biofizika” dhe i disa teksteve për shkolla të mesme të profileve të ndryshme. Ka botuar punime shkencore në revista në botën e jashtme dhe në ato vendore. Është pjesëmarrës me kumtesa në tubime shkencore të organizuara në vend dhe në botën e jashtme. (Rexhep Gashi)

VESELI Kadri (1967-). Njëri nga themeluesit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), drejtor i Drejtorisë së Shërbimit Informativ të UÇK-së, kryetar i Kuvendit të Kosovës dhe kryetar



KADRI VESELI

i Partisë Demokratike të Kosovës. Lindi në Mitrovicë, ku kreu shkollimin fillor dhe të mesëm. Në vitin 1985 filloi studimet në Universitetin e Prishtinës, në Fakultetin e Bujqësisë, të cilat i përfundoi në Universitetin e Tiranës. Në vitin 2010 përfundoi studimet pasuniversitare në Selanik të Greqisë, në Universitetin e Sheffield-it, ndërsa studimet e doktoratës për studime europiane i vazhdoi në Fakultetin e Shkencave Sociale në Universitetin e Lubjanës. Aktivitetin politik e filloi si student, si pjesëtar i Lëvizjes Popullore për Republikën e Kosovës. Nga viti 1991 kaloi në Shqipëri, për t'i bashkërenduar dhe intensifikuar veprimet politike dhe ushtarake. Nga viti 1993 deri më 1998 u mor me masivizimin e lëvizjes në pjesë të ndryshme të Kosovës, në Zvicër dhe gjetiu në diasporë. Ishte njëri ndër themeluesit e UÇK-së. Në mbledhjen e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së të mbajtur më 12

nëntor 1998 në fshatin Lladrofc të Malishevës u zgjodh drejtor i Drejtorisë së Shërbimit Informativ të UÇK-së. Gjatë Konferencës së Rambujesë (shkurt 1999) dhe asaj të Parisit (mars 1999) kishte rolin e koordinatorit të delegacionit kosovar. Pas marrëveshjes politike në mes nënshkruesve të marrëveshjes së Rambujesë, bashkësisë ndërkombëtare dhe me vendim të Qeverisë së Përkohshme të Kosovës, u krijua Shërbimi Informativ i Kosovës, në krye të të cilit u emërua K. Veseli. Ky shërbim, në koordinim me forcat paqeruajtëse të NATO-s, pati rol të rëndësishëm në krijimin e partneritetit me faktorin ndërkombëtar në fushën e sigurisë, si dhe në luftë kundër terrorizmit. Më 2 nëntor 2012, K. Veseli u anëtarësua në Partinë Demokratike të Kosovës (PDK), ndërsa në konventën e vitit 2013 u zgjodh zëvendëskryetar. Në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2014 u zgjodh deputet nga radhët e PDK-së, ndërsa në dhjetor të vitit 2014 u zgjodh kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës. Në maj të vitit 2016 në konventën e PDK-së u zgjodh kryetar i PDK-së. (Skënder Berisha)

VESELI Sali (1953-). Luftëtar i ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), ushtarak. Lindi në fshatin Smolicë të komunës së Gjakovës. Kreu gjimnazin dhe Akademinë Ushtarake në Beograd (1978). Shërbeu për 16 vjet në ushtrinë jugosllave, të cilën e braktisi që në fillim të shpërbërjes së ish-Jugosllavisë, në fillim të viteve '90 dhe emigroi në Gjermani. U angazhua në Qeverinë e Kosovës në emigrim, përkatësisht në strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Kosovës, në cilësinë e koordinatorit për ish-oficerë shqiptarë të ushtrisë jugosllave. Me fillimin e luftës në Kosovë, iu bashkëngjit radhëve të UÇK-së, duke kryer detyra në hartimin e strategjisë luftarake dhe udhëheqjes së operacioneve luftarake, deri në përfundim të luftës. Në qershor të vitit 1998 ishte shef i Shtabit të Zonës Operative të Dukagjinit dhe njëkohësisht komandant i UÇK-së për rajonin e Rekës së Keqe. Më vonë kreu edhe një varg detyrash e përgjegjësish ushtarake në Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së, ku u emërua shef i drejtorisë operative. Pas luftës u angazhua në Trupat Mbrojtëse të Kosovës. (Faton Mehmetaj)

VESHJET POPULLORE. Lloji i artit popullor që merret me prodhimin e veshjeve nga zejtarë



profesionistë ose njerëz të zakonshëm. Kosova është e njohur për veshjet popullore, të cilat, përveç vlerave historike, kulturore dhe estetike ofrojnë vlera muzeore si shenjë e jetës tradicionale. Veshjet tradicionalisht janë punuar prej leshi, pambuku, mëndafshi, kadifeje dhe lëkure, ndërsa janë shoqëruar me aksesore të ndryshëm prej druri, argjendi, ari, hekuri, çeliku etj. Shumica e veshjeve janë punuar me teknikën e qepjes dhe të endjes, por edhe në mënyrë industriale. Ato janë zbukuruar me dantella dhe qëndisje. Veshjet popullore dhe aksesoret e veshjeve janë punuar nga terzinjtë, kazazët, këpucëtarët, qeleshepunuesit, armëtarët dhe argjendarët. Disa prej ekzemplarëve janë punuar në mënyrë industriale dhe janë importuar nga jashtë.

Veshjet popullore më të njohura janë veshjet e rajoneve të Hasit të Prizrenit, Opojës, Rrafshit të Dukagjinit, Rugovës, Shalës së Bajgorës, Llapit, Malësisë së Gollakut, Drenicës, Karadakut të Gjilanit etj. Në veshjet popullore të meshkujve dominojnë tirqit, xhamadanët dhe lurkat përgjithësisht të bardha, të zbukuruar me gajtanë të zinj. Plisi është i bardhë dhe në shumë rajone është në formë të rrumbullakët, ndërsa në rajonet e Lumës dhe të Opojës në formë rrashatake. Pjesë të tjera të veshjeve ishin edhe shalli dhe shoka, stolitë, sumbulla argjendi, çorapët dhe opingat. Në të kaluarën burrat përdornin armë të zbukuruara, qostekë me orë xhepi, çibukë dhe kuti duhani. Tipi i veshjes së meshkujve me tirq sot rrallë gjendet në përdorimin e përditshëm, më shumë te të moshuarit. Ata tashmë mbajnë plisin të kombinuar me veshje allafrenga, të kohës. Shallvaret si veshje burrash janë përdorur kryesisht në qytete deri në fillim të shekullit XX. Ndërsa veshjet popullore të femrave për-

bëheshin nga këmisha, përparësja, xhamadani, shoka, çorapët, opingat, mbulesat e kokës dhe stolitë. Këmishët ishin të endura në veg prej fijesh mëndafshi ose pambuku. Përparëset dhe pështjellakët e pasmë kanë forma dhe madhësi të ndryshme. Pjesët më karakteristike të veshjes së Rrafshit të Dukagjinit janë mbulesat e kokës, lidhsa e marama, të endura prej pambuku të bardhë. Ndërkaq, në rajonin e Hasit të Prizrenit, te gratë myslimane dallohet kullani, i cili vihet në kërdhokulla. Ai është i punuar prej një copë dërrase, e cila mbushet me lecka dhe mbështillet me pëlhurë. Mbi të vihet brezi. Ndërkaq, veshjen e Drenicës e veçojnë stolitë e shumta prej rruazave të punuara nga gratë. Veshjet e grave me dimi përdoren kryesisht në qytete dhe në rajonet e Opojës, Gorës, Ana-drinit, Podgurit të Prizrenit, Zhupës, Suharekës, Jabllanicës, Llapit, Malësisë së Gollakut etj. Në veshje, armë dhe stoli paraqiten motivet florale, gjeometrike, zoomorfe, antropomorfe, si dhe motivet në formë të dragoit. Ornamentet kanë origjinë të lashtë dhe funksion zbukurimi, por shpesh edhe domethënie të besimeve të lashta magjike-apotropeike.

Veshjet popullore të burrave sot pothuajse kanë dalë nga përdorimi i përditshëm, ndërkaq veshjet popullore të femrave gjenden ende në disa rajone të Kosovës. (Shpresa Siqeca)

VETERANËT E ARSIMIT. Veprimtarë të arsimit, të cilët dhanë kontribut të veçantë në themelimin dhe zhvillimin e arsimit në Kosovë, sidomos në vitet e para pas Luftës së Dytë Botërore, siç ishin: Beqir Kastrati, Mehmet Gjevori, Ahmet Kelmendi, Abdurrahim Gashi etj. Ata bënë punë pionieri në fushën e arsimit dhe të shkollës shqipe në Kosovë. Punuan në kushte tejet të vështira ekonomike, politike dhe kulturore. U njësuan me arsimin dhe me shkollën shqipe. Vepra dhe personaliteti i tyre ishte frymëzues dhe udhërrëfyes për shumë breza mësuesish dhe arsimdashësish, të cilët e vazhduan punën e tyre me përkushtim. Kanë themeluar edhe shoqatat e tyre në disa komuna të Kosovës. (Demë Mulliqi)

VËLLAZËRIA. Grup gjinor ekzogam që i lidh familjet, apo pasardhësit e një paraardhësi të përbashkët me vijën atësore, përkatësisht të trungut patrilinear, që e mbulon të njëjtën hapësirë, të njëjtat kullota, që u detyrohet të njëjtave obligime të hakmarrjes. Shumë vëllazëri

përbëjnë fisin. Për shumë arsye institucioni i vëllazërisë në Shqipërinë e Veriut është ruajtur me të gjitha funksionet e tij, sidomos në raport me fisin. Këtu, në radhë të parë, hyn bashkëpunimi më i ngushtë, marrëveshjet për të gjitha vendimet e rëndësishme, respektimi i rolit të prijësit të vëllazërisë, ndjenja e afërsisë së gjakut, e cila e përjashton plotësisht martesën (duke e shndërruar vëllazërinë në shembull tipik ekzogam), përparësinë në pronësinë e patundshmërive, solidaritetin në dasma dhe mort etj. Pra, fjala është për një institucion, i cili në shumë funksione e zëvendëson grupin masiv të fisit. Vëllazëria merr të drejtën e reduktimit ose të ndërrimit të disa zakoneve, të cilat bien ndesh me mënyrën e re të jetës. Në krahasim me mjediset e tjera shqiptare, pjesa dërrmuese e Veriut shqiptar pasqyrohet edhe me faktin se shumica e mbiemrave përfundojnë me prapashtesën -aj. Ndonëse nuk ka sqarime të sakta shkencore për këtë gjë, dominon bindja se këta mbiemra janë me karakter patronimik dhe se janë plotësisht në frymën dhe natyrën e gjuhës shqipe: lidhen me emrin e të parit të tyre të afërt ose të largët, i cili do të ketë qenë zot shtëpie dhe njeri me autoritet, me të cilin është identifikuar e tërë familja. Pavarësisht nga distanca në breza, ndjenja e përkatësisë së një trungu të përbashkët në rastin e vëllazërisë ruhet ende. Ajo madje vazhdon të funksionojë si grup sociokulturor i veçantë mbi lidhjen e gjakut, afërsisë së brezave dhe solidaritetit, si në rast gazmendi, feste apo morti. Te shqiptarët e proveniencës katolike deri vonë vëllazëria e ka respektuar veshjen në të zeza, si shenjë e afërsisë së gjakut me familjen e të ndjerit. Solidariteti si dëshmi e afërsisë së gjakut është dëshmuar edhe në ngujim me familjen e dorasit nga vëllazëria, por edhe në ndihmë për t'u kryer gjakmarrja me familjarët e viktimës. (Anton K. Berishaj)

VËLLAZËRIT BAJÇINOVCI. Familja Bajçinovci u dëbua nga fshati Bajçinovci i Toplicës më 1878, për t'u vendos në fshatin Popovë të Llapit. Në këtë fshat lindi Rushit Bajçinovci (1884-1942), Hamiti (1886-1964), Haliti (1888-1970) dhe Sali Bajçinovci (1890-1970). Ata vazhduan traditën familjare të luftës kundër pushtuesve. Të gjithë vëllazërit morën pjesë në luftë kundër pushtuesve osmanë, si luftëtarë të Isa Boletinit, të Mehmet Konjuhut etj. Në vjeshtë të vitit 1912, në Popovë vritet

nga forcat serbe babai i tyre, Ahmeti, por vëllazërit Bajçinovci e vazhduan luftën kundër forcave serbe deri në vjeshtë të vitit 1915. Gjatë Luftës së Parë Botërore (1915-1918) me çetën e vet luftuan kundër pushtuesëve bullgarë dhe mbanin lidhje me Hasan Prishtinën. Vëllazërit Bajçinovci, së bashku me Hys Popovën dhe Mehmet Konjuhun, në vjeshtë të vitit 1919, dolën fitues në Kërshin e Sokolit në Popovë kundër 200 xhandarëve serbë. Më 1920 morën pjesë në kuvendin e Murgllës në Llap, në mesin e 600 kuvendarëve. Më 9 tetor 1920 vëllazërit Bajçinovci me Azem Bejtën në Çiçavicë luftuan kundër ushtrisë serbe, me ç'rast u bombardua Çiçavica nga aviacioni serbë i skuadrilës së Shkupit. Nën ndikimin e Hasan Prishtinës, Hoxhë Kadrisë dhe Bajram Currit morën pjesë në Revolucionin Demokratik në anën e Fan Nolit. Në periudhën korrik 1923-shkurt 1924 bashkëpunuan me Mehmet Konjuhun në krijimin e Zonës së Lirë në Dumnicë-Zagorth. Më 17 korrik 1924, bashkë me Mehmet Konjuhun, i shkojnë në ndihmë Azem Galicës së plagosur rëndë dhe marrin pjesë në varrimin e tij në shpellën "Çuku që Kerset" te Perçeva. Më 1925 me familje dolën në Shqipëri, u vendosën në nënprefekturën e Fierit në fshatin Dermenas. Më 1941 Rushiti dhe Hamiti kthehen në Kosovë me familjet e tyre dhe vendosen në Glllogoc. Gjatë Luftës së Dytë Botërore angazhohen për kauzën kombëtare, duke kundërshtuar haptas komunistët. Rushitin e vrasin në fshatin Leskoshiq forcat partizane serbe më 1944, ndërsa Hamiti me familje, më 1951 vendoset në Prishtinë. (Liman Rushiti).

VËRBANI. Fshat në lindje të Vitisë, rreth 5 km nga qendra komunale. Është vendbanim fushor i tipit të grumbulluar, me lidhje të mira komunikuese me qytezën e Vitisë. Është i banuar me popullsi serbe. Në vitin 2011 kishte 990 banorë, ndaj 667 banorëve në vitin 1948. Veprimtari kryesore ekonomike është bujqësia. Ky lokalitet ishte i banuar që nga koha iliro-romake, që e dëshmojnë gjurmët arkeologjike. Më herët ishte i banuar me shqiptarë, të cilët u shpërngulën në mënyrë të dhunshme, për t'u zëvendësuar me çipçi serbë, të cilët punonin tokën në kohën e Perandorinë Osmane. Nga objektet e standardit shoqëror ka shkollën e plotë fillore, disa njësi tregtare etj. (Shpend Agaj)

VICIANO. Stacion rrugor i periudhës antike. Sipas Tabula Peutingeriana gjendej në mes të qyteteve Vendenis dhe Theranda dhe është vendosur në radhë me stacionet e tjera përgjatë magjistrales Naissus-Lissus: "...Ad Fines XX - Vindenis XX - Viciano XXV - Theranda XXV..." Ubifikimi i këtij stacioni vazhdon të jetë i diskutueshëm në mesin e studiueseve. Supozimi më i pranueshëm duket të jetë ubifikimi të fshati Uglar, në afërsi të Prishtinës. (Arben Hajdari)

VIDISHIQI Arbana (1971-). Gazetare. Lindi në Mitrovicë. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Mitrovicë, ndërsa në Prishtinë studioi për arkitekturë. Në Londër përfundoi shkollën e lartë për teknologji dhe komunikime, përkatësisht kolegjin "Hendon" (Barnett-Hendon college). Më 1997 filloi punën si gazetare në të përditshmen "Koha ditore" në Prishtinë, ndërsa në mars të vitit 1999 u bë korrespondente nga Prishtina e Radios "Europa e lirë". Në vitin 2001 mori detyrën e shefes së zyrës të kësaj radioje në Prishtinë, në vitin 2011 u emërua në detyrën e shefes së programit për Kosovën në Radion "Europa e lirë", ndërsa më pas drejtore e shërbimit për Ballkanin e Radios "Europa e lirë" me seli në Pragë. (Rrahman Paçarizi)

VILA Sofi Sinan Pashë (?-1615). Udhëheqës ushtarak, vezir i Perandorisë Osmane. Lindi në fshatin Vilë të Lumës, që i takonte sanxhakut të Prizrenit. Mbajti disa pozita në Perandorinë Osmane, derisa në vitin 1594 kishte fituar pozitën e bejlerbeut të Kajros, e me pas bejlerbeut të Budimit. Në vitin 1596 ishte bejlerbej i Jegrit dhe më pas bejlerbej i elajetit të Anadollit, më 1607 bejlerbej i Bosnjës, kurse më 1608 vali në Damask. Vdiq gjatë rrugës për në Stamboll në vitin 1615 dhe është varrosur afër Galipolit, ku ekziston edhe tyrbja e tij. Ka lënë shumë vakëfe, si xhami, karavansaraje, imarete etj. Në vitin 1615 ndërtoi në Prizren xhaminë që mban emrin e tij, Xhamia e Sinan Pashës. (Sadik Mehmeti)

VILAJETI I KOSOVËS. Njësi territoriale-administrative e Perandorisë Osmane e formuar nga Porta e Lartë. Vilajeti i Kosovës është formuar në fillim të vitit 1877, në prag të shpërthimit të luftës ruso-osmane. Selia e këtij vilajeti ishte Prishtina, ndërkaq valiu i parë i tij

ishte Qamil Pasha, me origjinë shqiptare, i cili qëndroi shkurt në këtë post. Pas tij vali ishte Mahmud Nazif pasha. Vilajeti i Kosovës kishte aso kohe këto sanxhaqe dhe kaza: sanxhaku e Prishtinës (kazaja e Pejës, e Vuçitërnës, e Gjilanit, e Preshevës), me gjithsej 75,122 banorë; sanxhaku i Shkupit (nahija e Kaçanikut, kazaja e Kumanovës, kazaja e Shtipit, e Radovishtës, e Koçanës, nahija e Pijançës, e Maleshit, kazaja e Kratovës dhe e Pallankës) me gjithsej 112,547 banorë; sanxhaku i Prizrenit (nahija e Rahovecit, kazaja e Tetovës, nahija e Gostivarit, kazaja e Gjakovës, kazaja e Gucisë), me gjithsej 101,409 banorë; sanxhaku i Jeni Pazarit (kazaja e Jeni Pazarit, kazaja e Tashlixhes-Plevla, e Prijepoles, e Jeni Varoshit, nahija e Pribojit, kazaja e Akovës-Bellopojës, nahija e Vraneshit, kazaja e Mojkovcit, e Beranës dhe e Tërgovishtës-Rozhajës), me gjithsej 83,980 banorë; sanxhaku i Dibrës (kazaja e Elbasanit, e Dibrës së Poshtme dhe e Matit), me gjithsej 110,020 banorë. Nga këto të dhëna del se vilajeti i Kosovës në vitet 1878-79 ka pasur 483,078 banorë, pa banorët e kazasë së Preshevës, për të cilën mungojnë shënimet. Ky numër banorësh i vilajetit është klasifikuar sipas përkatësisë fetare, por shënimet përfshijnë edhe përbërjen kombëtare të popullatës. Përveç shumicës shqiptare, në përbërjen e popullsisë së vilajetit kishte edhe popullsi maqedone, vllahe, serbe, malazeze, boshnjake, turke dhe rome. Vilajeti i Kosovës kishte një numër të konsiderueshëm nëpunësish dhe institucionesh: Kuvendin administrativ të vilajetit, gjyqin e lartë, gjykatën e lartë për çështje civile dhe penale, komisionin arsimor, zyrën e kontabilitetit, zyrën e korrespondencës, arkivin, zyrën për regjistrimin e pasurive të patundshme, komisionin për regjistrim i Prishtinës, drejtorinë e kadastrës së sanxhakut të Prishtinës, këshillat e regjimentit dhe të batalionit të xhandarmërisë, kuvendin e bashkisë së Prishtinës, filialin e bankës agrare, drejtorinë e telegrafit, drejtorinë e tatimeve të Prishtinës, komisionin për ndihma, komisionin për muhaxhirë, drejtorinë e pyjeve të vilajetit dhe ruzhdijen e Prishtinës (shkollë shtatëvjeçare, progjimnaz). Si rezultat i kryengritjeve shqiptare, Porta e Lartë në vitin 1888 e transferoi qendrën e vilajetit në Shkup, duke vijuar të quhej vilajeti i Kosovës, por me kufij të ndryshuar. Shkupi si qendër e vilajetit

të Kosovës do të qëndrojë deri në fund të administrimit osman (1912), me sanxhaqet e Shkupit, Prishtinës Prizrenit, Pejës, Jeni Pazarit dhe Tashlixhës-Plevles. Vilajeti i Kosovës, sikurse më parë, edhe në përfundim të shekullit XIX ishte i ndarë në njësi të vogla administrative, në sanxhaqe, kaza dhe në nahije. Përveç valiu në krye të vilajetit, në administrim ishin të përfshirë edhe këta titullarë: mytesarifit në krye të sanxhakut, kajmekami në krye të kazasë dhe myhyri në krye të nahijes. Ndryshimet e shpeshta administrativo-territoriale të vilajetit të Kosovës, si dhe humbjet territoriale gjatë Krizës Lindore 1875-1878 u reflektuan edhe në numrin e banorëve të këtij vilajeti. Sipas sallnames së vitit 1878, vilajeti i Kosovës kishte 839,772 banorë, më 1879 kishte 483,078 banorë, në vitin 1882-83 kishte 311,980 banorë, sipas sallnames së vitit 1884-85 kishte 307,610 banorë, më 1893-94 kishte 847,419 banorë, në vitin 1896-97 kishte 865,101 banorë, ndërsa sipas sallnames së vitit 1900-1901 vilajeti i Kosovës kishte 964,657 banorë. Nga burimet relevante dëshmohet se në të gjitha këto faza popullsi dominuese e këtij entiteti administrativo-politik ishin shqiptarët. (Gazmend Rizaj)

VILAJETI I MANASTIRIT. Njësi administrative-territoriale në Perandorinë Osmane gjatë periudhës 1873-1912, me qendër në Manastir. Në fillim, në kuadër të vilajetit ishte pothuajse e tërë pjesa e Maqedonisë së sotme dhe pjesa perëndimore e Maqedonisë së Egjeut, duke hyrë thellë në territorin e Shqipërisë së Jugut dhe në një pjesë të vogël të territorit grek. Në vitin 1875 në përbërje të vilajetit ishin sanxhaku i Manastirit me kazatë: Ohër, Prilep, Manastir, Korçë, Kostur, Kozhan, Noselicë, Follorinë, Selfixhe, Kërçovë dhe Kolonjë; sanxhaku i Prizrenit me kazatë Prizren, Tetovë, Prishtinë, Gjakovë, Pejë, Gjilan, Vushtri e Guci; sanxhaku i Shkodrës me kazatë Shkodër, Podgoricë, Tiranë, Kavajë, Krujë (Akçe Hisarit) e Lezhë; sanxhaku i Shkupit me kazatë: Shkup, Kumanovë, Shtip, Kriva Pallankë, Radovish, Koçan e Kratovë; sanxhaku i Dibrës me kazatë: Dibra e Epërme, Elbasan, Dibra e Poshtme dhe Mat. Pas formimit të vilajetit të Shkodrës në vitin 1876, nga vilajeti i Manastirit u nda sanxhaku i Shkodrës, ndërsa me formimin e vilajetit të Kosovës në vitin 1877 vilajetit të Manastirit iu mor pjesa lindore e Maqedonisë

dhe Kosova, të cilat hynë në përbërje të vilajetit të porsaformuar të Kosovës. Në fund të shek. XIX, vilajeti i Manastirit kishte 800,000-900,000 banorë, ndërsa në vitin 1908 ky numër arriti në 1,000,576 banorë. Vilajeti i Manastirit shtrihej në një territor prej 32 mijë km² dhe kufizohej me vilajetin e Kosovës në Veri, me vilajetin e Selanikut në lindje dhe juglindje, me Mbretërinë e Greqisë në jug, me vilajetin e Janinës në jugperëndim dhe vilajetin e Shkodrës në perëndim dhe veriperëndim. Në krye të vilajetit qëndronte valiu që mbante titullin pasha, i cili caktohej me iradenë e sulltanit. Vilajeti pushoi së ekzistuari pas pushtimit serb në nëntor 1912. (Nebi Dervishi)

VILAJETI I SHKODRËS. Njësi administrative-ushtarake në Perandorinë Osmane e krijuar në vitin 1869, që përfshinte viset veriore të trevave shqiptare. Në reformën administrative të vitit 1814 parashihej krijimi i vilajetit të Shkodrës, por nuk u vu në zbatim për shkak të kundërshtimit të Mustafa Bushatliut dhe Ali Pashë Tepelenës. Me shtypjen e qëndresës feudale krahinore, në fillim të viteve '30 të shek. XIX u krijua Pashallëku i Shkodrës. Duke mos gjetur stabilitet, në vitin 1846 u krijua elajeti i Shkodrës, i cili ishte në vartësi drejtpërdrejt të Stambollit. Në reformën e vitit 1864 u kalua në sistemin e vilajeteve dhe në vitin 1869 u krijua vilajeti i Shkodrës. Fillimisht, në kufijtë e tij u përfshinë viset veriore dhe krahinat e Dibrës, të Matit, të Prizrenit dhe të Gjakovës. Në vitin 1873, kufijtë e vilajetit u ngushtuan me largimin e viseve të Kosovës dhe të Dibrës. Me këto ndryshime vilajeti i Shkodrës përbehej nga sanxhaku i Shkodrës (kazatë e Shkodrës, Lezhës, Ulqinit, Tivarit, Mirditës, Malësisë dhe Podgoricës) dhe sanxhaku i Durrësit (kazatë e Durrësit, Tiranës, Krujës dhe Kavajës). Gjatë periudhës 1878-1880, kazaja e Tivarit, e Ulqinit dhe Podgoricës u aneksuan nga Mali i Zi, ndërsa Gruda, Tuzi e Kelmendi mbetën në vilajetin e Shkodrës, duke u organizuar në kazanë e Tuzit. Kjo ndarje mbeti në fuqi deri në përfundim të sundimit turk. Në vitin 1904, kazaja e Krujës kaloi nga sanxhaku i Shkodrës në atë të Durrësit. Sipas statistikave të vitit 1912, vilajeti i Shkodrës kishte një sipërfaqe prej 10,270 km katrorë, me një popullsi 190,000 banorë, 98.2 për qind e të cilëve ishin shqiptarë, 0.6 për qind malazezë dhe 1.2 për qind të tjerë. Pas përfundimit të sundimit të Bushatlijve, Porta e Lartë nuk

arriti asnjëherë të normalizojë administrimin e vilajetit. Deri në vitin 1913, vilajeti i Shkodrës, si asnjë vilajet tjetër, u drejtua nga rreth 53 vali për shkak të abuzimeve, sidomos në dogana e banka, duke penguar zhvillimin. Megjithatë, sidomos dhjetëvjeçarin e fundit të sundimit turk, pati një zhvillim të dukshëm: u intensifikua tregtia me Stambollin dhe Perëndimin dhe tregtarët shkodranë vendosën agjentët e tyre në Durrës, Tiranë, Prizren, Pejë, Ulqin, Tivar, Shkup etj. Rreth 60 tregtarë kishin agjentët dhe korrespondentët në Trieste, nga ku lidheshin me tregun europian. Mori hov përpunimi i pëlhurës së mëndafshit, i veshjeve kombëtare, i lëkurës, duhanit, barutit dhe armëve etj. dhe u hapën disa shkolla në qytet e jashtë tij. U ndërtuan 25 km rrugë në qyteza dhe në periferi dhe u zmadhua porti, rada dhe magazinat, u urbanizua qyteti dhe lagjet kryesore të tij. Në vitet '80 u hap dega e Bankës Perandorake, si dhe dega e Bankës Bujqësore. U ngritën disa fabrika të vogla me motorë për prodhimin e miellit, të duhanit, tisazhit etj. Nga fundi i sundimit osman, me ndihmën e kapitalit të huaj, filloi shfrytëzimi i pyjeve, ndërtimi i një fabrike makaronash etj. Popullsia e vilajetit të Shkodrës mori pjesë aktive në një sërë kryengritjesh antiosmane. Gjatë Lidhjes Shqiptare të Prizrenit vilajeti i Shkodrës u kthye në vatër të rëndësishme të lëvizjes kombëtare. Dega e Lidhjes për Shkodrën dha ndihmesë për mbrojtjen e Playës e Gucisë, të Hotit e Grudës, të Ulqinit etj. Në vitin 1912 dhe fillimin e vitit 1913, vilajeti i Shkodrës u pushtua nga forcat e Aleancës Ballkanike dhe në vitin 1914 u bë pjesë e Principatës së Shqipërisë, sipas vendimeve të Konferencës së Paqes në Londër. (Endrit Musaj)

VINCA Agim (1947-). Poet, kritik letrar, profesor universiteti. Lindi në Veleshtë të Strugës (Maqedoni). Mbaroi edukimin fillor në vendlindje, të mesmin në Strugë, ndërsa studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Po në këtë fakultet kreu edhe magistraturën dhe mbrojtë tezën e disertacionit të doktoratës. Për shumë vjet, derisa u pensionua, ishte profesor i letërsisë së sotme shqipe në Fakultetin e Filologjisë të UP-së. Është autor që kultivon poezinë, kritikën dhe studimet letrare, esenë dhe publicistikën. Nga fusha e poezisë botoi librat: "Feniksi" (1972), "Bregu i mallit" (1975), "Në vend të



AGIM VINCA

biografisë" (1977), "Buzëdrinas" (1981), "Arna dhe ëndrra" (1987), "Kohë e keqe për liri-kën" (1997), "Sonet i vetmuar" (2001), "Psalmet e rrënjës" (2007), "Muza e mëmëdheut" (2012). Gjithashtu botoi disa përmbledhje dhe monografi nga fusha e studimeve dhe e kritikës letrare: "Aspekte të kritikës sonë" (1977), "Qasje" (1980), "Struktura e zhvillimit të poezisë së sotme shqipe" (1985), "Alternativa letrare shqiptare" (1995), "Panteoni i ideve letrare" (2003) etj., si dhe librat me shkrime eseistike dhe publicistike: "Populli i pandalur" (1992), "Shqiptarët mes mitit dhe realitetit" (1997), "(Po)etika e fjalës" (2010), "Arti i reagimit" (2011), "Metoda letrare" (Nga pozitivizmi deri te poststrukturalizmi (2016)). Si poet A. Vinca u prezantua në shumë antologji të poezisë shqipe të botuara në Kosovë, në Shqipëri dhe në Maqedoni, përfshirë edhe disa antologji të poezisë shqipe në gjuhë të huaja. Poezia e tij është përkthyer pothuajse në të gjitha gjuhët e rajonit, si dhe në anglisht, frëngjisht, arabisht, polonisht, rusisht etj. Si studiues i letërsisë ka dhënë kontribut të rëndësishëm për studimin e poezisë shqipe të gjysmës së dytë të shekullit XX, ndërsa në esetë dhe shkrimet e tjera publicistike ka trajtuar çështje të rëndësishme të jetës politike dhe shoqërore të botës shqiptare në periudha të ndjeshme të transicionit. Është marrë edhe me përkthime letrare, veçmas të poezisë dhe ka përpiluar disa antologji me poezi shqipe të përkthyer në gjuhë të rajonit. Për veprën e tij letrare ka marrë çmime letrare dhe mirënjohje. (Femi Cakolli)

VINCA Ilire (1970-). Aktore. Lindi në Strugë. Në vitin 1993 mbaroi aktrimin në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. Nga viti 1996 është e angazhuar si mësimdhënëse po në këtë fakultet. Një kohë punoi në Teatrin "Oda" si edukatore e certifikuar nga Nottingham Playhouse. Ka sinkronizuar serialin televiziv me kukulla "Ruga Sezam" dhe ka adaptuar një sërë librash për edukim shkollor. Në fushën e teatrit ka bashkëpunuar me artistë vendorë dhe ndërkombëtarë. Karriera e saj prej aktoreje ka filluar në vitin 1991 në Teatrin Popullor Krahinor. Në film ka interpretuar shumë role, ndër



ILIRE VINCA

të cilët: “Falja e gjakut” e realizuar nga J. Martsoni, pjesëmarrës në Festivalin e Filmit “Berlinale 2011” në konkurrencë zyrtare dhe njëkohësisht fitues i “Ariut të argjendtë” dhe çmimit special. Në vitin 2015 u paraqit sërish në konkurrencë zyrtare në

Festivalin “Berlinale” me filmin “Burrnesha”, në regji të L. Bispurit. Në mediumin elektronik interpretoi drama dhe filma televizivë. Në vitin 1992 mori çmimin si aktorja më e mirë në manifestimin teatror “Java e Dodonës” në qytetin e Pejës, ndërsa në vitin 2001 iu dha çmimi për aktoren më të mirë në Festivalin Ndërkombëtar në Prishtinë. Çmimin për aktoren më të mirë e mori edhe në Festivalin tradicional teatror “Apollon” në Fier, Shqipëri. (Jeton Budima)

VINCA Nuhi (1932-). Mbledhës e studues i folklorit, poet. Lindi në Veleshtë të Strugës (Maqedoni.) Shkollën fillore e kreu në vendlindje, të mesmen në Shkup, ndërsa studimet për gjuhë dhe letërsi i mbaroi në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës (1969). Po në këtë fakultet më vonë kreu studimet pas-universitare dhe mbrojti disertacionin e doktoratës (1986). Punoi si mësues dhe mësimdhënës në Strugë, në Kaçanik dhe në Ferizaj. Më 1977 u bë punëtor shkencor në degën e folklorit në Institutin Albanologjik të Prishtinës, ku punoi deri më 1991. Ka mbledhur materiale të vlefshme folklorike si në vendlindjen e tij, ashtu edhe në shumë vise të tjera në Kosovë dhe në Maqedoni. Mori pjesë me kumtesa në shumë tubime shkencore. Nga folkloristika ka botuar veprat monografike: “Lirika popullore shqiptare e dashurisë” (1989), “Lirika popullore shqiptare në regjionin e Strugës” (1992) dhe përmbledhjen e artikujve studimorë “Mbi poetikën e folklorit shqiptar” (1996), pastaj “Fabula të zgjedhura” (2001), “Antologji e lirikës popullore shqiptare gjithëkombëtare” (2004) etj. Botoi edhe një sërë përmbledhjesh me vjersha dhe poema për të rritur dhe për fëmijë (“Dallgë jugu”, 1867). Përktheu në gjuhën shqipe disa vepra të letërisë maqedonase, polake, kroate, serbe etj. (Visar Munishi)

VINCA-TUDA Shpresa (1939-1983). Mbledhëse e folklorit, etnologe dhe poete. Lindi

në fshatin Veleshtë të Strugës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, të mesmen në Ferizaj, ndërsa Shkollën e Lartë Pedagogjike në Shkup dhe më vonë edhe studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Universitetin e Prishtinës. Punoi si mësimdhënëse në një shkollë fillore e më vonë në Normalen e Ferizajt. Ishte bashkëpunëtorë e jashtme e Institutit Albanologjik të Prishtinës. Mblodhi materiale të shumta folklorike, kryesisht këngë të fëmijëve, të dasmës, vajtime etj. Janë të njohura vajtimet e mbledhura nga ajo në Veleshtë dhe rrethinë, të botuara në “Gjurmime albanologjike”, në serinë për folklor dhe etnologji. Është marrë edhe me etnologji dhe ka përshkruar disa nga doket e zakonet e vendit, si edhe motivet e veshjes dhe të jetës familjare në Veleshtë e në Strugë. Shkroi vjersha, tregime, skica, njëaktëshe për fëmijë, të cilat i botoi në gazetatat dhe revistat për fëmijë në Prishtinë e në Shkup. Botoi disa vepra letrare, kryesisht poezi për fëmijë: “Jeta jonë është pranverë” (1978), “O, ju moj lule” (1979), “Kur sështë nëna në shtëpi” (1985). (Ylberza Halili)

VIRGJËRAT E PËRBETUARA. Fenomen shoqëror i motivuar nga faktorë specifikë social-kulturorë dhe ekonomikë. Kryesisht lidhet me bijat pa vëllezër, të cilat, nën presionin e mekanizmave të detyrimit social, heqin dorë nga martesja dhe e ndërrojnë rolin e tyre gjinor. Ky fenomen lidhet kryesisht me ambientin gjeografik të brezit dinarik (Dalmaci, Bosnjë, Mal të Zi, Veriu i Shqipërisë, Kosovë.). Periudha e saktë kohore e paraqitjes së tyre nuk është e sigurt. Prindërit e familjeve pa djem zgjedhin njërën nga bijat e tyre (zakonisht më të voglën), për të marrë rolin gjinor të djalit, duke hequr dorë nga martesja. Nëse kanë vëllezër, njëra nga motrat e merr përsipër përkujdesjen familjare në rast të ngujimit të burrave nga gjakmarrja, ose të vdekjes së tyre, meqë, sipas traditës, institucioni i kollovarit si patriark ishte gati i përjashtuar. Karakteri patrilinear i shoqërisë ka implikime të fuqishme në marrjen e një vendimi të këtyllë, por nuk është dominues, krahas shumë faktorëve të tjerë. Kategorisë së veçantë të vajzave, të cilave që në (para) lindje u caktohej fati, nuk u lihej hapësirë e përzgjedhjes, meqë ato ishin privuar edhe nga sfida e marrjes së vendimit. Së këndejmi, fenomeni i virgjërave duhet kuptuar si veprim në harmoni me pritshmëritë shoqërore, në kontekstin e rrethanave specifike të jetës në

ambiente të caktuara. Befasitë që krijonin rrethanat e papritura të jetës familjare (humbja e ushqyesit të familjes, ngujimi familjar nga gjakmarrja, prishja e fejesës ose martesës etj.) janë dëshmuar si të favorshme për krijimin dhe ruajtjen e fenomenit të virgjërave të përbetuara. (Anton K. Berishaj)

VISARET E KOMBIT. Kolanë me materiale folklorike, që u botuan me rastin e 25-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë, më 1937. Përbën një koleksion prej 342 këngësh popullore, përrallash dhe legjendash, të cilat u mbledhën në popull në një periudhë brenda 40 vjetësh. “Visaret e kombit” ishte një projekt i realizuar nga fretërit e Urdhrit Françeskan në Shkodër, ndër të cilët më meritori ishte Atë Shtjefën Gjeçovi. Ai që në vitin 1905 e organizoi rininë françeskanë për të mbledhur “thesarin e fshehur në popull”. Etërit françeskanë Bernardin Palaj, Donat Kurti, Vinçenc Prenushi, Marin Sirdani, Simon Mikeli, Nikollë Dajçi etj. mbledhën përrallat, këngët kreshnike dhe legjendat derisa shërbyen në zonat e Malësisë së Madhe, në Dukagjin, në Kosovë, në Pukë, në Dibër, në Ljare e në Shestan. Nëpërmjet “Visareve të kombit” ata u dhanë jetë heronjve të këngëve kreshnike: Gjeto Basho Mujit, Zukut, Tale Budalinës, Balozit, Behurit; e mjediseve të zonave epike: Kotorreve, Lugjeve të Verdha, Jutbinës, Krahinës, Bjeshkëve të Thata etj. Nëpërmjet vëllimeve të “Përrallave kombëtare”, të cilat i mbledhi Atë Donat Kurti, lexuesi dhe studiuesi mund të njihet me pasurinë imagjinate të një bote mrekullish, ku veprojnë qeniet mitike, si: e Bukura e Dheut, Shtatë pllamë mjekra e tri pllamë shtati, Kacelmici, Hyria e Detit etj. Përveç punës së mirëfilltë në mbledhjen dhe regjistrimin e materialeve, autorët françeskanë i kanë pasuruar “Visaret e kombit” edhe me parathënie shpjeguese, ku ata shfaqin në mënyrë profesionale dijen e tyre dhe informacionin e gjerë për një punë të këtillë që kanë bërë popujt e tjerë në mbledhjen dhe regjistrimin e folklorit të tyre burimor. Këto vëllime sot vazhdojnë të ribotohen nga Biblioteka Françeskanë “Atë Gjergj Fishta” në Shkodër. (Arbnora Dushi)

VISOKA Avdi (1968-). Studiues i letërsisë, përkthyes, profesor universiteti. Lindi në Ballofc të Podujevës. Shkollimin e ka bërë në Podujevë, ndërsa studimet e gjuhës dhe të

letërsisë frënge i kreu në Fakultetin e Filologjisë në Prishtinë. Studimet pasuniversitare i kreu në degën e letërsisë shqipe dhe në Paris. Mbrojti temën e magistraturës dhe doktoratën në Prishtinë. Ka studiuar veprën e Albert Kamysë dhe ka botuar monografinë “Kamy - rrëfimi dhe idetë”. Ka botuar studimet “Koha e shkrimit” (1999), “Shkrim dhe receptim” (2016), ka përkthyer nga gjuha frënge “Njeriu i revoltuar” i A. Kamysë dhe ka botuar një numër studimesh në revistat shkencore të Kosovës. Nga viti 2003 punon në Universitetin e Prishtinës, në degën e gjuhës dhe letërsisë frënge. (Zejnullah Rrahmani)

VISOKA Halil Sheqir (Hoxhë Visoka) (1881-1945). Veprimtar arsimor dhe ushtarak gjatë Luftës së Dytë Botërore. Lindi në fshatin Ballofc të Podujevës. Shkollimin e fillestar e kreu në vendlindje, ndërsa studimet i vazhdoi në Stamboll dhe në Kajro. Gjatë Luftërave Ballkanike dhe Luftës së Parë Botërore kundërshtoi pushtimin serb të Kosovës. Në vitin 1934 u zgjodh deputet në parlamentin e Mbretërisë Jugosllave. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, me depërtimin e trupave gjermane në Kosovë, më 11 prill 1941 emërohet nënprefekt i Llapit, post që e mbajti deri më 1943. Në prill të vitit 1943, me krerët e Mitrovicës, Podujevës, Vushtrrisë, Novi Pazarit, Drenicës dhe të Podgurit dhe me pjesëmarrjen e ushtarakëve gjermanë u angazhua për riorganizimin e pushtetit në zonën gjermane të pushtimit. U angazhua gjithashtu në organizimin e arsimit shqip në rajonin e Llapit. Ishte anëtar i Këshillit të Pajtitit të Gjaqeve (Islihatit) për nënprefekturën e Podujevës. U përfshi në veprimtarinë e Lidhjes së Dytë të Prizrenit dhe u emërua komandant i zonës verilindore të kufirit shqiptar me Serbinë. Në fund të vitit 1944 nuk u largua nga vendi, por qëndroi në Podujevë. Në janar të vitit 1945 OZN-a e arrestoi dhe e zhduku pa gjurmë. (Arbër Salihu)

VISHI Bashkim (1977-1998). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), dëshmor. Lindi në Dubravë të Kaçanikut. Në maj të vitit 1998 iu bashkua njësitit të UÇK-së në Kaçanik, në Zonën Operative të Nerodimes. Më 4 gusht 1998 njësitet e Kaçanikut u vendosën në Jezerc të Ferizajt. Me skuadrën e tij mori pjesë në shumë aksione luftarake dhe beteja. Më 26-28

shtator 1998 forcat serbe ndërmorën ofensivë kundër UÇK-së në Jezerc. Më 28 shtator 1998, bashkë me disa bashkëluftëtarë të tjerë B. Vishi ra në vijën e parë të frontit. (Hajrush Kurti)

VITAKU Asllan (1945-). Inxhinier i teknologjisë, profesor universiteti. Lindi në Mitrovicë. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, ndërsa studimet në Fakultetin Teknik të Universitetit të Sarajevës. Kreu studimet pasuniversitare në Universitetin e Zagrebit. Ishte menaxher për mbrojtje të mjedisit dhe drejtor në flotacionin e minierës “Trepça” në Stantërg. Në Fakultetin e Xehetarisë dhe të Metalurgjisë në Mitrovicë ishte titullar i lëndëve në departamentin e teknologjisë inorganike, të inxhinierisë kimike dhe inxhinierisë së mbrojtjes së mjedisit. Specializimin në fushën e shkencave të teknologjisë së plumbit e kreu në kompaninë franceze “Panarroya Noyelle Godault”. Më pas bëri vizita studimore në SHBA, Japoni, Kazakistan, Bullgari etj. Mori pjesë në disa konferenca shkencore dhe botoi punime shkencore në revista ndërkombëtare. (Avni Terziqi)

VITIA. Qytezë në rajonin e Anamoravës, në jugperëndim të Gjilanit. Shtrihet në juglindje të Republikës së Kosovës. Është nyjë e rrugëve të rëndësishme kombëtare dhe ndërkombëtare.



VITIA

Në lindje lidhet me Gjilanin dhe Bujanocin, ndërsa në perëndim me Ferizajn, përkatësisht, magjistralen Prishtinë-Shkup. Lidhjet e komunikacionit rrugor automobilistik Vitia i ka me Gjilanin dhe Ferizajn, në largësi të barabarta prej 21 km, ndërsa, linja hekurudhore Ferizaj-Shkup ndodhet vetëm 13 km larg saj. Me kryeqendrën e Kosovës, Prishtinën, lidhet

me rrugë automobilistike në dy drejtime, nëpër Ferizaj me gjatësi prej 55 km dhe nëpër Gjilan me gjatësi prej 67 km. Largësia e Vitisë nga aeroporti i Prishtinës dhe ai i Shkupit është 80 km. Qyteza shtrihet në zonën e fushës së Moravës së Binçës, në lartësi mbidetare 490 m. Nëpër këtë qytezë rrjedh lumi Morava e Binçës. Karakterizohet me sipërfaqe relativisht të rrafshët dhe toka bujqësore me cilësi të lartë. Funkcionin e qendrës urbane e fiton më tepër në saje të shërbimeve administrative, sesa të madhësisë demografike. Brenda periudhës 1948-2011 numri i popullsisë është katërfishuar. Derisa në vitin 1948 qyteza kishte 1,781 banorë, në vitin 2011 në të jetojnë 4,924 banorë. Veprimtaritë kryesore ekonomike janë bujqësia, tregtia dhe industria. Është qendër e rëndësishme e arsimit parashkollor, fillor dhe të mesëm. Nga objektet e standardit shoqëror, Vitia ka qendrën e mjekësisë familjare, teatrin e qytetit, bibliotekën, objektet sportive etj. (Nexhat H. Rexha)

VITIA (komuna). Shtrihet në pjesën juglindore të Kosovës, rreth 40 km në jug të Prishtinës. Kufizohet me komunën e Gjilanit, të Ferizajt, të Kaçanikut dhe në jug me Maqedoninë.

Nëpër territorin e kësaj komune kalojnë rrugët me rëndësi kombëtare dhe ndërkombëtare. Përmes këtyre rrugëve, komuna e Vitisë lidhet me Gjilanin dhe Bujanocin në lindje, ndërsa me Ferizajn në perëndim, përkatësisht me magjistralen Prishtinë-Shkup. Territori i komunës i takon masivit kristalor të Rodopeve. Shtrihet mes maleve të Karadakut (Malit të Zi) të Shkupit dhe maleve të Zhegovcit, në lartësi mesatare mbidetare 650 m. Në territorin e saj dallohen tri tërësi morfologjike: zona e ulët e fushës së Moravës së Binçës, zona kodrinore-malore e Karadakut dhe ajo e maleve të Zhegovcit. Komuna e Vitisë ka klimë të mesme kontinentale, nën ndikimin e erërave veriore, verilindore dhe perëndimore. Temperaturat më të larta mesatare janë shënuar në muajin Korrik me 21°C, ndërsa temperatura më e ulët mesatare në janar me -1°C. Temperatura mesatare vjetore sillet rreth 11.5°C. Lumi kryesor i kësaj komune është Morava e Binçës. Ky lumë nga ana e djathtë mbledh ujërat e Mjakut, Letnicës dhe Gërçarit, ndërsa nga ana e majtë mbledh ujërat e Smirës, Gëlbushës, Tërpezës, Zhitisë etj. Komuna e Vitisë është e pasur edhe me burime termale. Gjatë Perandorisë Osmane komuna e Vitisë

ishite pjesë e nahisë së Moravës. Në regjistrimin osman të vitit 1455, Vitia si vendbanim kishte 104 shtëpi. Gjatë Luftës së Parë Ballkanike (1912) Vitia me rrethinë okupohet nga Serbia. Gjatë Luftës së Parë Botërore okupohet nga Bullgaria. Në periudhën e Luftës së Dytë Botërore ishte pjesë e zonës okupuese bullgare, ndërsa në vjeshtën e vitit 1944 ripushtohet nga Jugosllavia. Vitia në vitin 1912 u shpall komunë, ndërsa gjatë kohës së Mbretërisë Jugosllave ishte pjesë përbërëse e Banovinës së Vardarit, me qendër në Shkup. Në vitin 1952 nga qarku i Gjilanit formohen tri rrethe: Gjilani, Vitia dhe Kamenica, ndërsa në vitin 1959, kur transformohen rrethet, Vitia bëhet komunë më vete. Është komunë tipike agrare, me dominim të popullsisë rurale, me 39 fshatra dhe një qendër urbane. Deri në vitin 2009, kjo komunë përfshinte 297 km², por me formimin e komunës së re të Klokotit ajo zvogëlohet për 23 km². Me Planin e Ahtisarit për decentralizim, nga territori i saj u formua komuna e Klokotit, e cila përfshin në vete katër vendbanime. Derisa në vitin 1948, komuna e Vitisë kishte 23,708 banorë, në regjistrimin e fundit (2011) morën pjesë 46,978 banorë. Veprimtaritë kryesore ekonomike janë: bujqësia, industria, tregtia, zejtaria dhe shërbimet-hoteliere. Nga institucionet edukativo-arsimore ka një çerdhe me 18 paralele, 17 shkolla të ciklit të ulët fillor dhe dy shkolla të mesme në gjuhën shqipe dhe serbe. Sistemi shëndetësor është i organizuar në gjashtë qendra të mjekësisë familjare. (Nexhat H. Rexha)

VITKOVIQ Millovan (Milovan Vitković) (1934-2015). Fotoreporter. Lindi në Mirash të Ferizajt, në një familje kolonësh të ardhur nga Hercegovina. Në vendlindje mbaroi shkollën fillore, ndërsa zejen e fotografit e mësoi në studion e fotografit të njohur të Prishtinës, Neshat Dizdari-Nesha. Më pas për fotografinë gazetareske mësoi nga fotografi Zhivojin Ajdaniq, i cili kryente punën e fotoreporterit në gazetën “Jedinstvo” dhe “Rilindja” pas Luftës së Dytë Botërore. Nisi bashkëpunimin me gazetën “Rilindja” që më 1953, ndërsa nga viti 1958, kur “Rilindja” u shndërrua në gazetë të përditshme, M. Vitković bëhet fotoreporter i saj. Në “Rilindje” punoi deri në vitin 1985, kur kaloi me punë në gazetën “Jedinstvo” të Prishtinës. Për punën e tij mori shumë çmime dhe mirënjohje. (Zenun Çelaj)

VITOMIRICA. Fshat në verilindje të Pejës, rreth 3 km larg nga qyteti. Është fshat i tipit të shpërndarë. Në kohën e Mbretërisë Jugosllave në këtë vendbanim u sollën si kolonë 428 familje serbe dhe malazeze, të cilëve iu ndanë nga 5 ha tokë. Në vitet e ‘60 fillojnë të vendosen edhe familje shqiptare dhe myslimane të ardhura nga Rozhaja dhe Berani. Në vitin 1948 fshati kishte 1.632 banorë, ndërsa në vitin 2011 fshati numëron 5.409 banorë. Nga objektet e standardit shoqëror ka shkollën, shtëpinë e shëndetit, shtëpinë e kulturës, zyrën e vendit etj. Aktualisht konsiderohet pjesë periurbane e qytetit të Pejës. (Shpend Agaj)

VIZEL Eli (Elie Wiesel) (1928-2016). Shkrimtar, profesor dhe aktivist politik hebre. Lindi në Sighet të Rumanisë. Në moshën 15-vjeçare me gjithë familje u dërgua në Aushvic. Pas Luftës së Dytë Botërore u vendos në Paris, ku studioi për letërsi, filozofi dhe psikologji në Universitetin e Sorbonës. Në vitin 1955 u zhvendos në SHBA. Ishte profesor në Universitetin e Bostonit. U përfshi në kauzën hebreje dhe ndihmoi në themelimin e Muzeut Memorial të Holokaustit në Uashington. Libri i tij “Natë” (Night) konsiderohet ndër veprat më të rëndësishme për dokumentimin e Holokaustit. Në vitin 1986 fitoi Çmimin Nobel për Paqe. Gjatë luftës në Bosnjë dhe në Kosovë doli në anën e boshnjakëve dhe shqiptarëve të viktimizuar, si dhe në mbështetje të ndërhyrjes së NATO-s në Kosovë. Më 1999 u emërua i dërguar i presidentit amerikan Bill Clinton për monitorimin e refugjatëve dhe të dëbuarit shqiptarë në Maqedoni dhe në Shqipëri. (Valdrin Ukshini)

VJETARI STATISTIKOR I KOSOVËS. Vjetarët statistikorë janë një nga botimet më të veçanta dhe më të rëndësishme për Agjencinë e Statistikave të Kosovës. Vjetari i parë statistikor në Kosovë është publikuar në vitin 1976 nga Enti i Statistikave i Kosovës, për të vazhduar me publikimin e tyre në baza vjetore, deri në vitin 1989, kur është publikuar vjetari i fundit statistikor. Gjatë kësaj periudhe gjithsej janë publikuar 14 vjetarë statistikorë. Përmbajta e këtyre vjetarëve është shumë e pasur me informata të hollësishme për situatën ekonomike dhe shoqërore dhe është e ndarë në tri pjesë: pjesa e parë përfshinte seritë shumëvjeçare të të dhënave, të cilat paraqesin

zhvillimin e Kosovës; pjesa e dytë jep të dhëna sipas republikave dhe krahinave autonome; ndërsa pjesa e tretë përmban zgjedhjen e të dhënave kryesore, me të cilat paraqitet zhvillimi i komunave. Agjencia e Statistikave e Kosovës në periudhën e pas luftës së vitit 1999 ka arritur të publikojë dy vjetarë statistikorë, për vitin 2014 dhe vitin 2015, të cilët ofrojnë të dhëna të pasura gjeografike, për ekonominë familjare dhe banesat, për arsimin, kulturën dhe sportin, të dhënat për mirëqenien sociale dhe për shëndetësinë, si dhe të dhënat për jurisprudencën. Statistikat e tregut të punës ofrojnë të dhëna për popullsinë sipas moshës, arsimit, statusit të punësimit, shkallës së varfërisë dhe shkallës së aktivitetit për të gjitha veprimtaritë ekonomike dhe treguesit kryesorë makroekonomikë të Kosovës. Të dhëna të tjera të rëndësishme që përfshihen në vjetarin statistikor janë edhe të dhënat për sektorin financiar të Kosovës, indeksin e çmimeve të konsumit, indeksin e çmimeve të importit dhe indeksin e çmimeve të prodhimit. Disa tregues, krahasuar me statistikatat ndërkombëtare, mund të gjinden në këta vjetarë statistikorë. Publikimet janë nxjerrë edhe në formë elektronike, duke lehtësuar kështu përdorimin e të dhënave nga të interesuarit. (Rahmije Mustafa-Topçiu)

VLORA Ismail Qemal (1844-1919). Politikan, deputet, diplomat, themelues dhe kryeministri i parë i shtetit shqiptar. Lindi në Vlorë në një nga familjet më të mëdha dhe me shumë



ISMAIL QEMAL
VLORA

ndikim të Shqipërisë së Jugut. Shkollën fillore e kreu në vendlindje. U diplomua në gjimnazin "Zosimea" në Janinë. Studimet për drejtësi i kreu në Stamboll. Gjatë kësaj kohe punoi në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Perandorisë Osmane. Më pas u specializua në Paris në shkencat juridike dhe ekonomike. Përveç gjuhës shqipe njihje edhe osmanishten, turqishten e re, greqishten e vjetër, latinishten, italishten dhe frëngjishten. Jetoj dhe veptoi në disa shtete: Shqipëri, Greqi, Turqi, Itali, Bullgari, Siri, Francë, Angli, Zvicër dhe Gjermani. U martua dy herë. Me gruan e parë, Nasipen nga Konica, nuk pati fëmijë, pasi ajo vdiq gjatë

lindjes së parë. Më 1886 u martua me Kleoniqi Surmeli, vajza e një fisniku grek, me të cilën pati 10 fëmijë: gjashtë djem dhe katër vajza. Në vitin 1868 u emërua drejtor i Sekretariatit në Zyrën Juridike në Sofje të Bullgarisë dhe më pas mori detyrën e prefektit të rajonit të Rusçukut, detyrë që e mbajti për 5 vjet. Në vitin 1876 u emërua sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Jashtme të Perandorisë Osmane. Në këtë detyrë qëndroi një vit. Kjo pozitë e ndihmoi që të krijojë eksperiencë në diplomacinë turke dhe të vërë kontakte me diplomacinë ndërkombëtare. Këmbëngulja e tij për zbatimin e reformave demokratike e çoi në konflikt me rrethet konservatore të Stambollit. Më 1877 Porta e Lartë e akuzoi si kundërshtar të politikës së sulltan Abdyl Hamitit II dhe përkrahës të pikëpamjeve liberale të Mithat Pashës (funktionar i lartë i Perandorisë, ministër i Punëve të Jashtme, reformator). Për këto arsye, Porta e Lartë e dënoi me 7 vjet internim në qytetet Kytahja, Eskishehir dhe Bursë të Anadollit. U lirua më 1884 dhe u emërua si mytesarif i sanxhakut të Mardinit, më pas mytesarif i sanxhakut të Goliopolit dhe guvernator i vilajetit të Bejrutit (1890-1892). Sulltani e emëroi guvernator të Vilajetit të Tripolit (Libi), ku I.Qemali qëndroi përreth një vit (1894-1895), më pas u largua nga ky post. Pastaj u emërua këshilltar personal i sulltan Abdyl Hamitit, në kohën kur Perandoria Osmane ishte në rënie, gjatë viteve 1892-1900. Në maj të vitit 1900 u largua nga Turqia, duke i kërkuar dorëheqjen sulltanit. Në dhjetor të vitit 1908, zgjidhet deputet i Beratit, por në fakt përfaqësonte gjithë Shqipërinë. Në pranverën e vitit 1909 u pozicionua kundër xhonturqve dhe u zgjodh kryetar i Partisë Liberale (Ahrar), e cila synonte të decentralizonte Perandorinë Osmane. Gjatë viteve 1910-1912 u dallua si frymëzues dhe organizator i kryengritjeve kundërosmane. Në qershor të vitit 1911 së bashku me L. Gurakuqin dhe patriotët të tjerë hartoi Memorandumin e Greçës dhe në fund të atij viti mori nismën për organizimin e kryengritjes së përgjithshme të vitit 1912. I. Qemali gjatë veprimtarisë së tij bëri përpjekje të vazhdueshme për ta bindur qeverinë osmane t'u jepte shqiptarëve autonominë. Gjatë Luftës së Parë Ballkanike, së bashku me L. Gurakuqin e patriotët të tjerë, organizoi veprimtari politike për të shpallur Pavarësinë e Shqipërisë. Më 5 nëntor 1912 gjeti

përkrahjen e Kolonisë shqiptare të Bukureshit. Më vonë u nis drejt Vjenës, ku u takua me personalitete politike austro-hungareze e me përfaqësues diplomatikë të Fuqive të Mëdha dhe siguroi përkrahjen e tyre për çështjen shqiptare. Ndryshimi i shpejtë i qëndrimit politik të Fuqive të Mëdha ndaj Perandorisë Osmane e bindi I. Qemalin se duhej thelluar kërkesa politike, duke e shtruar pavarësinë e vendit si të vetmen zgjidhje. Më 19 nëntor 1912 njoftoi bashkatdhetarët se do të mblidhej në Shqipëri një Kuvend Kombëtar, i cili do të shpallte Pavarësinë. Pasi u kthye me bashkëpunëtorët e tij në Shqipëri, thirri në Vlorë mbledhjen e Kuvendit Kombëtar. Në këtë kuvend, që u mbledh nën kujdesin e tij më 28 nëntor 1912, shpalli deklaratën e Pavarësisë së Shqipërisë dhe ngriti Flamurin Kombëtar. Fjalimin e tij I. Qemali e lexoi në gjuhën shqipe. Vendimi i parë i I. Qemalit, pas firmosjes së Deklaratës së Pavarësisë dhe marrjes së detyrës si kryeministër i parë, ishte dërgimi i lajmit në të gjitha qarqet e vendit dhe i telegrameve në shtetet e mëdha për njohjen e Pavarësisë së Shqipërisë. Në politikën e jashtme u tregua i lirë nga paragjykimet kundrejt fqinjëve, më të cilët kërkonte të kishte marrëdhëniet miqësore, por edhe kundërshtar i synimeve të tyre për të copëtuar Shqipërinë. Qeveria e kryesuar nga I. Qemali, ndonëse në kushte shumë të vështira të brendshme e të jashtme, mori një varg masash për organizimin dhe ndërtimin e shtetit të pavarur, si dhe në fushën e ekonomisë e të kulturës kombëtare, që i hapnin vendit rrugën e zhvillimit demokratik. Ajo mbrojti pranë Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit dhe pranë kancelarive të Fuqive të Mëdha të drejtat e ligjshme të popullit shqiptar për tërësinë territoriale të atdheut. Në të gjitha këto veprime I. Qemali u tregua burrë shteti dhe diplomat largpamës. Megjithatë, Fuqitë e Mëdha nuk e njohën Qeverinë e tij. Në tetor të vitit 1913 ato caktuan në krye të shtetit shqiptar Vilhelm Vidin dhe formuan një dërgatë të kryesuar nga E. Toptani për t'i ofruar zyrtarisht princit gjerman fronin e Shqipërisë. I. Qemali dha dorëheqje më 22 janar 1914, duke ia dorëzuar pushtetin Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit, si institucion i krijuar në Konferencën e Ambasadorëve në Londër, me shpresë se edhe në këtë mënyrë do ta ndihmonte të ardhmen e Shqipërisë. Pas dorëheqjes I. Qemali u largua nga Shqipëria. Në mbarim të

Luftës së Parë Botërore mori vesh për Traktatin e Fshehtë të Londrës, ku parashihej copëtimi i Shqipërisë. Ai mendonte se “paqja në Ballkan nuk do të mund të rivendoset duke sakrifikuar të drejtat e kombeve të tjera në interes të synimeve ekspansioniste. Pa iu shtuar Shqipërisë nga ana e veriut Kosova dhe nga ana e jugut Çamëria, nuk mund të shtrohet qetësia në Sinisinë e Ballkanit”. Në verën e vitit 1918, më qëllim të përkrahjes së çështjes shqiptare qëndroi në Spanjë, ku mori përkrahjen e emigrantëve shqiptarë të SHBA-së për t'i përfaqësuar në Konferencën e Paqes në Paris. Më 15 janar 1919 nga Peruxhia e Italisë i dërgoi kryeministrit italian Orlando parashtrësën që dëshironte ta paraqiste në Konferencën e Parisit. Por Italia, në këto rrethana, nuk përkrahte Shqipërinë e pavarur. I. Qemali u nda nga jeta më 26 janar 1919, në rrethana të dyshimta, në hotelin “Brufani” të Peruxhias. (Teki Kurti)

VLLAHIU Arbër (1967-). Gazetar. Lindi në Prishtinë, ku kreu shkollën fillore dhe të mesme. Studioi për letërsi dhe gjuhë shqipe në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës. Bëri studime master për gazetari dhe komunikime masive dhe trajnime e specializime në Londër dhe Athinë. Nga viti 1994 deri në vitin 2000 punoi korrespondent i Radio-Suedisë nga Prishtina, pastaj korrespondent për Radio-Danimarkën dhe gazetar në gazetën “Koha ditore”. Më 1999 ishte producent në Radiotelevizionin e Suedisë, si dhe korrespondent për radion “Deutsche Welle”, për të kaluar po atë vit në Radio BBC, emisioni në gjuhën shqipe, ku punoi deri në mbylljen e seksionit shqip më 2011. Në periudhën 2002-2004 punoi si producent i BBC-së në Londër, ndërsa nga viti 2011 ishte këshilltar politik për medie dhe marrëdhënie me publikun në zyrën e presidentes së Kosovës, Atifete Jahjaga. Së fundi u emërua shef i zyrës së Prishtinës i Radios “Europa e lirë”. (Rrahman Paçarizi)

VLLASA Ramë (1882-1921). Luftëtar i çetave kryengritëse kundër pushtimit osman dhe serb. Lind në Balloç të Llapit. Më 1906 inkuadrohet në çetën kryengritëse të Shaqir Igrishtës, për të luftuar në dy fronte: kundër osmanëve dhe kundër sulmeve serbe. Për dy dekada u përball me sulmet serbe mbi fshatrat kufitare shqiptare në vijën Murgull-Përpellac-Merdar-Kullë e Asqerit-Metërgofç-Bujanoc. Gjatë viteve 1912-

1917 organizoi pesë çeta luftarake, të cilat i drejtonin Jashar Xhakja, Hamdi Repa, Ejup Lladovci dhe Bel Bajçinovci. Më 1916 vihët në ballë të luftëtarëve në Merdar, që synonin çlirimin e Sanxhakut të Nishit. Në nëntor të vitit 1916, së bashku me Hoxhë Visokën, e ngritën flamurin shqiptar në Kurshumli dhe Prokupje. Ishte pjesëmarrës në Kuvendin e Murgullës, ndërsa më 1920 radhitet në anën e Azem Bejtës dhe Komitetit të Kosovës. Vritet në një pritë në kufi në veri të Kosovës. (Hakif Bajrami)

VLLASI Azem (1948-). Funkionar politik i Kosovës në periudhën e autonomisë. Lindi në Rubofc të Kamenicës. Shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në Kamenicë, diplomoi në



AZEM VLLASI

Fakultetin Juridik në Prishtinë. Ushtri funksione të larta politike në Kosovë dhe në Jugosllavi. Ishte kryetar i Lidhjes së Studentëve të Kosovës dhe Kryetar i Lidhjes së Rinisë Socialiste të Jugosllavisë, Kryetar i Lidhjes Socialiste të Popullit Punues të Kosovës, Kryetar i Komitetit Krahinor të Lidhjes së Komunistëve të Kosovës (1986-1988) dhe anëtar i Kryesisë së Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë. Pas vitit 1981 u shqua për diskurs të ashpër ndaj pjesëmarrësve në demonstrata dhe përfaqësoi udhëheqjen e re të Kosovës, të ngritur mbi të ashtuquajturën luftë kundër nacionalizmit dhe irredentizmit shqiptar dhe mbi diferencimin ideopolitik. Më 1988 u akuzua nga pushtetarët e Serbisë si organizator i tubimeve masive të shqiptarëve dhe i grevës së minatorëve të Stantërgut në Trepçë. Në mars të vitit 1989 u burgos së bashku me udhëheqjen e Trepçës dhe u dënua më 14 muaj burg. U lirua nga burgu në maj të vitit 1990, pas një presioni të shtuar të institucioneve ndërkombëtare. Që nga viti 1993 punon si avokat dhe është aktiv në jetën publike, posaçërisht në shoqërinë civile dhe si analist në medie. Është autori i librit “Mjeshtrit e errësirës” (1991) dhe ka botuar një sërë shkrimesh autoriale në shtypin e vendit dhe të huaj. (Daut Bislimi)

VLEHTË. Eksonim përmbledhës për grupet etnike parasllave të Ballkanit, që flasin gjuhë

të afërta romane. Vetë etnonimi *vllah* rrjedh nga gjermanishtja. Fillimisht me këtë emër u quajtën keltët e romanizuar, ndërsa më vonë u përhap për grupet etnike të romanizuara dhe vetë popujt romanë të Europës, përfshirë edhe ata të Gadishullit të Ballkanit. Quhen edhe arumunë, kucovlleh, karagunë, cincarë dhe (te shqiptarët) çoban e gogë. Lidhur me prejardhjen dhe me përkatësinë etnike të vllahve të Ballkanit, studiuesit mbështesin mendimin se janë popullsi e vjetër iliro-trake, përkatësisht trake-ilire e romanizuar, e cila nga pushtues të ndryshëm u dëbua nga qytetet e nga viset rrafshinore-bujqësore dhe banuan malet e larta, duke u marrë me blegtori transhumane. Njoftimet më të hershme për vllhtë në hapësirat e Dardanisë, përkatësisht të Kosovës së sotme gjenden në shkrime kishtare serbe të shek. XIII-XIV. Nga këto burime mësohet se vllhtë (si edhe arbanasët) i përkisnin shtresës shoqërore që zeje kryesore e kishin blegtorinë transhumane dhe se tani ishin bërë pronë e sundimtarëve serbë, që ua falnin kishave dhe manastireve që po ndërtonin. Megjithatë, kisha dhe pushtuesi serb ua njihte vllahve në shek. XIII-XV të drejtën e tyre zakonore, të njohur nëpër burime të shkruara si “Ligji i vllahve”, “Kanuni i vllahve” (*Vlaško pravo e Jus Walachorum*), i respektuar gjithandej ku kishte vllah, përfshirë edhe Kosovën e sotme. Vendbanimet e tyre shtriheshin kryesisht rreth Bjeshkëve të Nemuna, Pashtrikut, Sharit, Shalës së Bajgorës e Çiçavicës. Mirëpo vllah kishte në atë kohë edhe në katunde rrafshinore në gjithë hapësirën e Kosovës së sotme. Por mbetet ende e panjohur nëse bëhet fjalë për popullatë vendëse romane-ballkanike, apo për vllhtë që erdhën në jug të Ballkanit në shek. X, pas migrimit nga atdheu i mëparshëm i tyre, Rumania. (Skënder Gashi)

VOCA Adem (1903-1945). Luftëtar antikomunist. Lindi në Melenicë të Shalës së Bajgorës. Pas vdekjes së babait, Beqirit, u zgjodh anëtar i Islihatit. Pas vitit 1941 mobilizoi vullnetarë për mbrojtjen e popullatës shqiptare nga sulmet e ushtrisë jugosllave dhe çetnike. Në shtator 1943, si delegat i nënprefekturës së Vushtrrisë mori pjesë në Kuvendin e Lidhjes së Dytë të Prizrenit. U zgjodh kryetar i Komitetit të Rinisë Shqiptare për Mbrojtjen e Kosovës në Vushtri. Gjatë kësaj periudhe udhëhoqi vullnetarët kundër sulmeve të forcave çetnike mbi

popullatën civile në veriun e Kosovës, në Novi Pazar, Sjenicë, Rozhajë etj. Në fund të luftës u angazhua kundër forcave pushtuese gjermane. Më 22 janar 1945, në Kuvendin e Vidishiqit, ku u formua Brigada e Shalës, u zgjodh komandant i saj. Kundërshtoi çarmatosjen e shqiptarëve nga organet e administratës komuniste si dhe dërgimin e të rinjve shqiptarë në Frontin e Sremit. Më 23 janar 1945 organizoi një takim në Stantërg, kurse të nesërmen në Bare u bashkëngjitën mbi një mijë vullnetarë, të cilët më 26 dhe 27 janar 1945 marshuan drejt Stantërgut, duke e çliruar atë. Më 8 shkurt 1945, A. Voca me grupin prej shtatë luftëtarësh vendosi të kthehej në kullën e tij, në Sumë afër Vushtrrisë. Më 10 shkurt 1945 forca të mëdha partizane rrethuan kullën në Sumë, ku më 11 shkurt u vra edhe A. Voca. (Fazli Hajrizi)

VOCA Beqir (1841-1925). Atdhetar, pleqnar. Lindi në Melenicë të Stantergut. Bashkëpunoi me Isa Boletinin. Pas pushtimit të Kosovës nga ushtria serbe (1912), sidomos pas ripushtimit të saj (1918) dhe formimit të Mbretërisë Serbe-Kroate-Slllovene, u angazhua kundër shpërnguljes së shqiptarëve të kësaj ane në Turqi. Deri në vitin 1922 kreu detyrën e kryetarit të Shalës së Bajgorës me qendër në Bare. Duke qenë në pozitën e kryetarit, ndihmoi popullsinë me të gjitha mundësitë që kishte dhe bashkëpunoi me lëvizjen kaçake, duke i mbrojtur ata sa herë që organet e pushtetit dhe xhandarmëria serbe u binte në gjurmë dhe i rrezikonin. Gjithashtu ndërhynte edhe te prefekti i Mitrovicës për veprimet brutale të xhandarmërisë serbe ndaj popullsisë së pambrojtur. (Fazli Hajrizi)

VOCA Sherif (1896-1941). Veprimtar i Shalës së Bajgorës, kryetar komune, deputet. Lindi në Melenicë, afër Trepçës. Më 1912, bashkë me të atin, mori pjesë në Kuvendin e Kurillovës, ku u lidh besa midis Shalës dhe Llapit për organizimin e luftës kundër osmanëve. Kundërshtoi pushtimin serb të Kosovës më 1912. Gjatë sundimit austro-hungarez (1916-1918) u angazhua për hapjen e shkollave në Mitrovicë dhe rrethinë dhe organizimin e pushtetit lokal. Pas ripushtimit të Kosovës dhe themelimit të Mbretërisë Serbe-Kroate-Slllovene, në zgjedhjet e vitit 1922 u zgjodh kryetar komune në Bare. Postin e mbajti për 12 vjet. Në zgjedhjet e vitit 1935 u zgjodh në mesin


e tetë deputetëve shqiptarë në Parlamentin Jugosllav. Është i njohur fjalimi i tij në Parlamentin e Jugosllavisë në Beograd (1937), ku dënoi marrëveshjen jugosllavo-turke për shpërnguljen e shqiptarëve për në Turqi. Për shkak të kërcënimeve, u detyrua të ikte në Shqipëri, më pas në Egjipt, Greqi etj. Më 1940 u kthye në Mitrovicë. Iu kundërvu vrasjeve të ushtarëve shqiptarë në garnizonin e Mitrovicës dhe të civilëve nga oficerët e ushtrisë serbe. Më 14 prill 1941 u vra nga ushtarët serbë, derisa po përpiqej të kalonte në Shalë, për të organizuar bashkëvendësit për mbrojtje nga ushtria serbe. (Fazli Hajrizi)

VOJNOVIQ Bogolub (Bogoljub Vojnović) (1906-1976). Dirigjent dhe kompozitor. Lindi në Beograd. Kreu studimet për muzikë në Pragë të Çekosllovakisë. Ishte anëtar i orkestrës ushtarake në Nish, Kragujevc dhe në Beograd. Gjatë viteve 1949-1960 punoi në Prishtinë. Këtu zhvilloi një aktivitet të gjerë muzikor, duke udhëhequr korin e Shoqërisë “Radnički”, si dhe Orkestrën e Qytetit. Me këtë të fundit ka përgatitur disa shfaqje operetash në Teatrin Popullor Krahinor. B. Vojnoviq ka pasur prirje edhe për kompozime. Në disa vepra të tij, përpos kompozimeve për orkestër me frymë, ka inkuadruar dhe motive e ritme popullore shqiptare, si në “Rapsodinë shqiptare” për orkestër të tij, tek orkestralja “Me këngë e valle nëpër Kosovë” dhe “Marshi i brigadave kosovare”. (Zeqirja Ballata)

VOKA Rexhep (1847-1917). Veprimtar i lëvizjes kombëtare, klerik. Lindi në Shipkovicë të Tetovës. Shkollimin e kreu në medresetë e Tetovës. Në vitin 1868 u regjistrua në Fakultetin e Teologjisë Islame në Stamboll. Në vitin 1903 u emërua myfti i vilajetit të Manastirit. U përfshi në lëvizjen për çlirim dhe emancipim kombëtar. Më 1906 morri pjesë në Kongresin e Bukureshtit, bashkë me Ismail Qemailin. Më 1907 ishte pjesëmarrës në mbledhjen e Ferizajt, si përfaqësues i Tetovës. Duke qenë myfti i vilajetit të Manastirit, u bë pritësi dhe përkrahësi kryesor i Kongresit të Alfabetit në Manastir (14-22 nëntor 1908). Në këtë Kongres përkrahu idenë e shkrimit të shqipes me alfabet arab, çka u kundërshtua nga veprimtarë të Rilindjes. Me këtë alfabet botoi edhe një abetare (“Elifbaja shqip”, 1910) dhe një libër mësimi të shqipes e të normave të fesë islame

(“Mendime”, 1911). Gjuha e këtyre veprave ruan tiparet e të folmeve të rrethinave të Tetovës. Në vitin 1909 mori pjesë në Kongresin e Dibrës, të organizuar nga xhonturqit, ku u zgjodh në pleqësinë e Kongresit, e cila shprehu diferenca përballë qëndrimeve të xhonturqve. Pas këtij aktiviteti pushohet nga detyra e myftiut dhe pas pushtimit serb (1912) largohet nga vendlindja. Vdiq në Stamboll më 1917. (Alban Dobruna)

VOKRRI Avdullah (1935-2011). Mësimdhënës universiteti, pedagog. Lindi në Sfeçël, Podujevë, ku kreu edhe shkollën fillore. Të mesmen e filloi në Podujevë dhe e përfundoi në



AVDULLAH
VOKRRI

Normalen e Prishtinës. Studioi pedagogjinë në Fakultetin Filozofik të Prishtinës, ku edhe magjistroi dhe doktoroi. Punën profesionale e filloi si mësues, pastaj mësimdhënës gjimnazi dhe i paraleleve normale në Podujevë, redaktor

i teksteve shkollore në Entin e Teksteve dhe Mjeteve Mësimore të Kosovës dhe drejtor i tij. Ndërkohë, u angazhua edhe mësimdhënës i lëndëve pedagogjike në Shkollën e Lartë Pedagogjike të Prishtinës, në Fakultetin e Mësuesisë, përkatësisht të Edukimit në Prishtinë. Përveç artikujve dhe studimeve shkencore-profesionale, A. Vokri është autor i disa veprave kryesisht nga historia e arsimit shqiptar: “Zhvillimi i shkollave dhe i arsimit në komunën e Mitrovicës prej vitit 1945-1975” (1980), “Bazat gnoseologjike-filozofike, didaktike-metodike, gjuhësore-stilistike dhe teknike-grafike të tekstit shkollor” (1986), “Shkollat dhe arsimit në Kosovë ndërmjet luftërave botërore, 1918-1941” (1990), “Shkollat dhe arsimit në anën e Llapit 1878-1944” (1995), “Jashar Erebara-jeta dhe vepra” (2000), “Shkolla Normale e Prishtinës 1953-1974” (2004), “Mësuesit në Kosovë e në Shqipëri” (2009) etj. (Naser Zabeli)

VOKRRI Fadil (1960-). Futbollist. Lindi në Sfeçël të Podujevës. Njihet si futbollisti më i njohur dhe i adhuruar në Kosovë. E filloi karrierën në KF “Llapi” të Podujevës, më pas u bë pjesë e KF “Prishtina”. Një periudhë ka veshur edhe fanellën e KF “Partizani” të Beo-



FADIL VOKRRI

gradit. Skuadra italiane “Juventusi” i Torinos në vitin 1987 shfaqti interesimin për të dhe i ofroi firmosjen e një kontrate afatgjatë. Asokohe Fadil Vokri u cilësua si lojtari më i mirë i vitit në Jugosllavi. Mirëpo, pasi ftesa që Fadil Vokri të shkojë në shërbim të detyruar ushtarak. Pas “Partizanit” luajti në “Nim” të Francës, ndërkaq në periudhën 1990-1992 në “Fenerbahçe” të Stambollit. Karrierën vepruese e mbylli në Francë, ku u vendos me banim dhe ku ushtroi zejen e trajnerit të futbollit të ligës së dytë. Më pas u kthye në Kosovë dhe mori detyrën e drejtorit të KF “Prishtina”. Më vonë u zgjodh kryetar i Federatës së Futbollit të Kosovës. (Baki Berisha)

VOKSHI Afrim (1930-). Inxhinier i ndërtimitarisë, profesor universiteti. Lindi në Tiranë. Kreu shkollimin në Tiranë dhe Prishtinë, ndërsa studimet në Fakultetin e Ndërtimitarisë



AFRIM VOKSHI

të Universitetit të Beogradit. Në fillim punoi në Shkup e më pas si projektues i strukturave në Tetovë, në Gostivar (“Mavrovë”) dhe në Shkup (Pellagonia”). Studimet pasuniversitare i kreu në Universitetin e Shkupit (1971). Në vitin 1976 u

specializua në fushën e konstruksioneve metalike në Universitetin Politeknik në Temishvar, Rumani, ndërsa disertacionin e mbrojti në Fakultetin Teknik të Universitetit të Prishtinës (UP) (1979). Nga viti 1969 ishte ligjërues në Fakultetin Teknik të UP-së, më vonë merr titujt docent dhe profesor inordinar, kurse më 1986 u zgjodh profesor ordinar. Botoi tekstin universitar “Konstruksionet e ndërtesave metalike” (1986). Fushat kryesore të studimeve të tij ishin ndërtesat metalike, mbajtësit hapësinorë dhe urat metalike. Që nga themelimi i Universitetit Shtetëror të Tetovës ishte i angazhuar në punë pedagogjike-mësimore. Është autor i shumë punimeve shkencore dhe ka marrë pjesë në kongrese, simpoziume dhe konferenca shkencore e profesionale. Aktualisht jeton në Shkup. (Fetah Jagxhiu).

VOKSHI Alije (1945-). Piktore. Lindi në Prishtinë. Kreu shkollimin fillor dhe të mesëm në Prishtinë, studimet i përfundoi në Akademin e Arteve Figurative në Beograd. Është e njohur



ALIJE VOKSHI

si krijuese e pikturës abstrakte ekspresioniste. Është anëtare e Shoqatës së Artistëve Figurativë të Kosovës (SHAFK) nga viti 1970 dhe në kuadër të saj realizoi një sërë prezantimesh brenda dhe jashtë vendit. Hapi ekspozita vetjake në Prishtinë (1970-1976) dhe Beograd (1981). Si anëtare e SHAFK-ut gjithashtu mori pjesë në disa ekspozita kolektive në periudhën 1973-2015, si në sallonet pranverore, në sallonet e nëntorit, pastaj në bienalet e vizatimit dhe në manifestimet e tjera të organizuara në Kosovë dhe jashtë. Është laurate e çmimit “Mosha Pijada” (1973) dhe e mirënjohjeve të tjera publike. Nga viti 1974 ishte mësimdhënëse e lëndës së vizatimit në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. (Hajrush Fazliu)

VOKSHI Asim (1909-1937). Veprimtar i lëvizjes komuniste, pjesëmarrës në Luftën e Spanjës. Lindi në Gjakovë. Shkollën fillore e nisi në vendlindje, e kreu në Kolgecaj, ndërsa



ASIM VOKSHI

gjimnazin e kreu në Shkodër. Në vitin 1929 regjistrohet në Akademinë Ushtarake të këmbësorisë në Modena të Italisë, ku në verë të vitit 1931 gradohet në titullin e nëntogerit. Pas kthimit në Shqipëri, nuk qëndroi gjatë, sepse u dërgua në Firence, për specializim në degën e karabinierisë. Pas kthimit, merr detyrën e ndihmëskomandantit të xhandarmërisë në Pogradec. Zhvillonte veprimtari ilegale në bashkëpunim me Ali Kelmendin, Vasil Shanton, Petro Markon etj. Më pas shërbeu si ushtarak në Delvinë dhe së fundi në Tiranë, në seksionin e mbrojtjes së rendit publik. Në prag të shpërthimit të kryengritjes së Fierit në vitin 1935 u arrestua dhe u dënua me burgim e internim. Pas lirimit nga burgu, për pak kohë nuk punoi fare. Në nëntor të vitit 1935, pas dekretimit të ligjit për shprehje të lirë, me

të cilin hiqej censura, u angazhua për botimin e revistës “ABC”. Revistën e administronte A. Vokshi, drejtor ishte Petro Marko, ndërsa bashkëpunëtorë Reshat Këlliçi, Skënder Rusi, Tajar Zavalani, Branko Merxhani etj. Por pas numrit të dytë revista u mbyll, për shkak të përhapjes së ideve komuniste. Në janar të vitit 1937 shkoi në Spanjë, për të luftuar kundër fashizmit dhe në mbrojtje të Republikës. U rreshtua në Brigadën XII “Garibaldi”, ku u emërua komandant i kompanisë së parë të batalionit të tretë, që kishte 125 luftëtarë. Pas shumë betejave të përgjakshme, u vra në një nga luftimet e ashpra në frontin e Ebros më 4 tetor. U dekoruar me Urdhrin e Skënderbeut dhe më 1949 u shpall Hero i Popullit. (Kosovar Basha)

VOKSHI Beqir (1895-1923). Pjesëmarrës i kryengritjeve kundërosmane dhe i qëndresës kundër pushtimit serbo-malazez në trevën e Dukagjinit. Lindi në Gjakovë, ku kreu dhe shkollën fillore e të mesme. Që në moshë të re mori pjesë në kryengritjen antiosmane të vitit 1910-1912, po ashtu edhe gjatë pushtimit serbo-malazez. Veçanërisht u shqua me veprimtarinë e tij patriotike pas formimit të “Komitetit Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”. Dega e Gjakovës ishte dega më e organizuar e këtij Komiteti. Anëtarë të kësaj dege ishin intelektualë dhe luftëtarë të njohur të kohës, si: Qazim Bakalli, Niman Ferizi, Tahir Zajmi, Sali Mani, Avdyll Qerimi, Ibrahim Fehmiu etj. B. Vokshi, së bashku me bashkëpunëtorët e tij, në vitin 1918 u angazhuan për mbledhjen e të dhënave për masakrat serbe, që bëheshin mbi popullsinë shqiptare, si dhe përpiluan statistikat e strukturës së popullsisë së Kosovës. Shënimet iu dërguan “Komitetit Mbrojtja Kombëtare e Kosovës” në Shkodër, me synim për të denoncuar para opinionit ndërkombëtar terrorin dhe dhunën e Mbretërisë Serbo-Kroate-Slllovene mbi shqiptarët. U vra në Junik në rrethana të pasqaruara. (Alban Dobruna)

VOKSHI Haxhi (1940-2013). Poet, bibliotekar. Lindi në Voksh, komuna e Gjakovës. Kreu arsimin fillor në Drenoc të Deçanit, shkollën e mesme në Pejë, ndërsa studimet në degën e gjuhës dhe të letërsisë shqipe të Fakultetit Filozofik të Prishtinës. Punoi si mësimdhënës në Gjilan, më pas në Sekretariatit Krahinor për Arsim, Kulturë dhe Shkencë në Prishtinë.

Më pas kaloi në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, ku punoi deri në pensionim. Poezitë e para i botoi në revistën “Jeta e re” dhe në “Flaka e vëllaznimit”. Botoi veprat: “Shqetësimi i vargut” (1971), “Koha e ditës sonë” (1980), “Përralla e kulla” (1987), “Udhëtim me korbin” (1994), “Liria këndon vetë” (2003), “Testamenti i tokës” (2008). H. Vokshi kultivoi poezi me motive të ndryshme, gjithnjë në afërsi me këndimin dhe vargun popullor. (Isak Shema)

VOKSHI Myftar (1913-1998). Mësues, veprimtar i arsimit. Lindi në Gjakovë, shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa gjimnazin në Tiranë. Studimet e larta për matematikë i vijoi në Firence (Itali). Në vitin 1936 u emërua edukator në strehën vorfnore në Tiranë, pastaj nëpunës në Ministrinë e Arsimit në Shqipëri. Në vitin 1942 u burgos me akuzën për ndihmë Lëvizjes Antifashiste. Në Ministrinë e Arsimit në Shqipëri punoi edhe pas Luftës së Dytë Botërore. Në vitin 1948 u kthye në Kosovë dhe punoi në Drejtoratin e Arsimit të Kosovës. Ishte edhe drejtor i progjimnazit në Pejë dhe drejtues i kurseve pedagogjike. Për shkaqe politike, autoritetet e kohës e mënjanuan nga procesi mësimor dhe e angazhuan nëpunës në administratën e rrethit të Gjilanit. Në periudhën 1955-1968 ishte nëpunës në seksionin e arsimit të komunës së Gjakovës. (Valentina Nimonaj-Hoti)

VOKSHI Sabrije (Bije) (1892-1984). Pjesëmarrëse në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare në Kosovë dhe Shqipëri. Lindi në Gjakovë. Që në moshë të re ishte aktiviste dhe mori pjesë në luftën për çlirimin e Shqipërisë. Pas vitit 1913, kur Kosova u pushtua nga Serbia, u dallua në luftë kundër pushtuesit serb të Kosovës. Ishte anëtare e Komitetit “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”. Në vitin 1935 nga Kosova u vendos në Tiranë. Pas pushtimit të Shqipërisë nga Italia fashiste u aktivizua në Lëvizjen Nacionalçlirimtare. U angazhua që në lëvizje të përfshiheshin sa më shumë vajza dhe gra shqiptare. Në shtëpinë e saj u mbajt mbledhja e kuvendit themelues të Rinisë Komuniste Shqiptare. Në vitin 1942, Partia Komuniste e Shqipërisë e dërgoi në Kosovë për të ndihmuar në organizimin e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Në fund të vitit 1943 dhe në fillim të vitit 1944 mori pjesë

në Konferencën e Bujanit. Përfaqësoi në këtë Konferencë gratë antifashiste. Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore u tërhoq nga jeta publike. Vdiq në Prishtinë. (Frashër Demaj)

VOKSHI Selman (1937-2010). Mësimdhënës i muzikës, vjershëtar. Lindi në Durrës. Në vitin 1941 kthehet me prindërit në fshatin e tyre Vakaj të Kikës afër Poliçkës. Arsimin për muzikë e filloi në Prizren dhe e përfundoi në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prishtinë. Në vitin 1958 filloi punën si mësimdhënës në Shkollën fillore “Skënderbeu” në Hogosht. Ishte arsimtari i parë shqiptar i muzikës në shkollat e Anamoravës. Për 15 vjet drejtoi korin e Shkollës Normale të Gjilanit. Me korin e shkollës u prezentua edhe në qendra të ndryshme të ish-Jugosllavisë. Më vonë ishte redaktor i muzikës në Radio-Gjilan. Ndonëse u verbërua, u mor edhe me krijimtari letrare. Shkroi poezi dhe poema, disa nga të cilat arriti t’i botonte. U quajt “Homeri shqiptar”. (Hajrullah Koliqi)

VOKSHI Sulejman (1815-1887). Luftëtar i Lëvizjes Kombëtare dhe njëri nga liderët e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (LSHP). Lindi në Gjakovë. Në Kuvendin themelues të LSHP-së u zgjodh anëtar i Komitetit Qendror dhe kryetar i Komisionit për Financa. Iu bashkua krahut patriotik të Lidhjes kundër rrymës sulltaniiste. Pas vrasjes së Abdullah Drenit, u zgjodh kryetar i degës së LSHP-së në Gjakovë, deri kur



SULEJMAN VOKSHI

e zëvendësoi Ali Aga (1880) për shkak të angazhimeve të shumta në Komitetin Qendror në Prizren. Mori pjesë në vrasjen e Maxharr Pashës në Gjakovë dhe, bashkë me Riza Kryeziun e Bajram Currin, ishte në krye të 2,000 vullnetarëve në luftën për mbrojtjen e Plavës dhe të Gucisë (1879-1880). Pas këtyre ngjarjeve, S.Vokshi me bashkëmendimtarët e tij themeluan në Gjakovë (21 mars 1880) Lidhjen e Re. Në Qeverinë e Përkohshme (janar 1881) u zgjodh komandant i forcave të armatosura. Gjatë kësaj periudhe, kjo qeveri shtriu pushtetin e saj në Shkup, Prishtinë, Mitrovicë, Vushtrri etj. Por mareshali Dervish Pasha, pas Shkupit (7 prill 1881) hyri në Ferizaj (16 prill 1881), ku

iu dorëzuan disa veprimtarë të LSHP-së. Qeveria e Përkohshme iu dërgoi një memorandum Fuqive të Mëdha, ku kërkohej ndalimi i ekspeditës ndëshkimore të mareshalit osman dhe mbrojtja e autonomisë së Shqipërisë. Për të mbrojtur Prizrenin, forcat e LSHP-së, nën komandën e S. Vokshit, Mic Sokolit, Binak Alisë, Ali Ibrës zunë pozitat në Shtime e Carralevë. Por, pas një qëndrese të shkurtër, forcat e Lidhjes pësuan disfatë në Slivovë, në Dule dhe në Suharekë. Ato u tërhoqën në Gjakovë. Posa hyri në Prizren (22 prill 1881), Dervish Pasha ftoi krerët e Lidhjes që t'i paraqiteshin në afat të caktuar. Nuk iu paraqitën vetëm Y. Prizreni, A. Frashëri, S. Vokshi dhe A. Ibra. Pas rënies së Gjakovës (10 maj 1881), Dervish Pasha e riktheu pushtetin në tërë Kosovën. Lidhja filloi aksionin e rimëkëmbjes së degëve. Më 24 prill 1883, në Kastrat u formua Lidhja e Re e Fiseve të Shqipërisë Veriore për t'u mbrojtur nga Mali i Zi. Ndërkohë, S. Vokshi me bashkëpunëtorë kishte krijuar një zonë të lirë në Malësinë e Gjakovës, nga Qafa e Prushit deri në Qafë të Morinës. Në gusht 1884 kryengritjes së sanxhakut të Prizrenit iu bashkua edhe popullsia e trevës së Gjakovës. U bënë përpjekje për rimëkëmbjen e degëve të Lidhjes në vilajetin e Kosovës dhe të Manastirit. Por Porta dërgoi mareshalin Vesel Pasha, i cili, pas masave që mori për të siguruar qetësinë në Prizren (gusht 1885), iu drejtua Gjakovës, ku, nën drejtimin e S. Vokshit, po bëheshin përgatitje për të formuar sërish Lidhjen e Re. Ai ia dogji shtëpinë S. Vokshit (27 gusht 1885) dhe e arrestoi atë. Me të dëgjuar këtë, A. Ibra u përpoq pa sukses ta ndihmojë. Prandaj Gjykata Ushtarake e Prizrenit e dënoi me vdekje, kurse familjen me internim në Fezan (7 tetor 1885). Por Sulltani e liroi atë dhe familjen e tij. Pëzullimi i dënimit me vdekje vinte si rezultat i kryengritjes çlirimtare të popullit bullgar të Rumelisë Lindore dhe i bashkimit të saj me Bullgarinë. Pas këtyre ngjarjeve, Porta e Lartë e ndryshoi qëndrimin ndaj shqiptarëve: pezulloi zbatimin e reformave, iu lejoi malësorëve mbajtjen e armëve dhe lejoi përdorimin e gjuhës shqipe në shkolla. Vesel Pasha kërkoi ndjesë nga krerët shqiptarë për konfliktet e fundit dhe premtoi tërheqjen e ushtrisë nga Prizreni e Gjakova. Sulltani liroi shqiptarët e arrestuar e të internuar, midis tyre edhe S. Vokshin dhe A. Frashërin. Me shëndet të rrënuar nga luftërat dhe me barrën e viteve, S. Vokshi u nda shpejt nga jeta. Me rastin e

100-vjetorit të LSHP-së u shpall Hero i Popullit. (Masar Rizvanolli)

VOKSHI Xhafer (1924-2012). Veprimtar i Lëvizjes Nacionalçlirimtare, i persektuar i komunizmit. Ishte vëlla i Asim Vokshit, pjesëmarrës në luftën e Spanjës. Lindi në Gjakovë.



XHAFER VOKSHI

Bashkë me familje emigroi në Shqipëri, ndërsa gjatë luftës së Dytë Botërore u kthye sërish në Kosovë. Shkollën fillore e filloi në Gjakovë dhe e mbaroi në Tiranë, ndërsa gjimnazin e kreu në Gjirokastrë. Që në shkollë të mesme u përfshi në Lëvizjen Antifashiste Nacionalçlirimtare. Shumë shpejt ra në sy të pushtetit fashist dhe u burgos. Pak ditë para kapitullimit të Italisë fashiste (1943), u arratis nga burgu i Tiranës dhe iu bashkua njësiteve partizane të Pezës. Më 1944 kthehet në Kosovë dhe i bashkohet njësiteve partizane në Malësi të Gjakovës, duke marrë pjesë në shumë aksione luftarake. Organizoi rininë antifashiste në Tiranë, Pezë, Lumë, Has, Tropojë, Gjakovë etj. Ishte pjesëmarrës në Konferencën e Bujanit. Ai përshëndeti organizimin e kësaj konference në emër të Rinisë Antifashiste të Kosovës. Në vitin 1946 u formua Komiteti Nacional i Shqiptarëve të Kosovës, ku Xh. Vokshi u zgjodh kryetar i Organizatës së Rinisë Shqiptare. Në vitet e pasluftës nga Kosova u ekstradua në Shqipëri. Në vitin 1956 në Konferencën e Komunistëve të Tiranës ra në konflikt me vijën partiake. U burgos dhe u dënua me pesë vjet burg. Pas burgut u izolua në Ballsh për vite të tëra. Gjatë diktaturës komuniste, ai dhe familja e tij, u përdoqën dhe u dënuan me internime të gjata. Pushteti komunist në Shqipëri ia hoqi të drejtën e ushtrimit të profesionit të gazetarit dhe të drejtën e botimit. Vdiq në Durrës. (Luan Tetaj)

VOLEJBOLLI. Në Kosovë filloi të luhet nga viti 1948. Ekipet e volejbollit u themeluan në Prishtinë, Pejë, Mitrovicë, Gjakovë, Prizren dhe Gjiilan. Nismëtarë të këtij sporti në Kosovë ishin Bardhyl Zajmi, Ali Dauti, Hasan Shala, Hasan Berisha, Rexhep Xhiha, Nexhat Begolli etj. Deri në vitin 1990 Kosova ka pasur disa skuadra në ligat cilësore të ish-Jugosllavisë, ndër të cilat ishin "Prishtina",



NJË NDESHJE VOLEJBOLLI

“Elektroekonomia”, “Universiteti” (femrat), “Vëllaznimi”, “Partizani” etj. Viti 1990 ishte viti i ndarjes nga aktivitetet sportive në ish-Jugosllavi. Më 1991 filloi organizimi i garave të volejbollit, në konkurrencën e meshkujve, kryesisht në formë të turneve, në ambiente rurale dhe në palestra të shkollave. Kampione të Kosovës gjatë kësaj periudhe (1991-1999) në konkurrencën e femrave kanë qenë: “Drita” e Gjilanit, “Kastrioti” i Ferizajt dhe “Gjinoci”. Në konkurrencën e meshkujve kampione të Kosovës kanë qenë: “Dukagjini” i Klinës, “Suhareka”, “Flaka” e Preshevës, “Bresalci” dhe “Drita” e Gjilanit. Pas përfundimit të luftës në Kosovë, volejboli vazhdoi garat në të dy konkurrencat. Dy volejbollistë të “Prishtinës” (Adriatik Kajtazi dhe Gazmend Husaj) që nga viti 2007 janë anëtarë të përfaqësues së Shqipërisë dhe me sukses kanë luajtur në elitën e volejbollit të Shqipërisë, Zvicrës, Maqedonisë, Italisë dhe të Turqisë. Nga viti 2009 edhe Bardhyl Hajdaraj i Prishtinës mori ftesën për të qenë pjesë e kombëtares shqiptare, ndërkohë luajti për “Studentin” e Tiranës. Shemsije Asllanaj dhe Vlora Hasani, po ashtu kanë qenë pjesë e përfaqësueses së Shqipërisë në konkurrencën e femrave. Në vitin 2016 FVK-ja u pranua në Federatën Botërore të Volejbollit dhe në Konfederatën Europiane të Volejbollit me të drejta të plota. (Baki Berisha)

VORONINA Irina (Ivanovna) (1939-2007). Gjuhëtare ruse, profesoreshë, përkthyesë, albanologe. Lindi në fshatin Murashi, afër qytetit Kirov. Studimet i kreu në Leningrad (1962). Në vitet 1959-1961 bëri stazh në Universitetin e Tiranës dhe më pas punoi në Universitetin e Leningradit (1962-2007), ku mbajti mësimet e shqipes, të dialektologjisë shqiptare dhe

të gramatikës së shqipes. Ka marrë pjesë në Seminarin e Gjuhës, Letërsisë dhe Kulturës Shqiptare në Prishtinë që nga viti 1976, si dhe në veprimtari të tjera shkencore në fushën e studimeve shqiptare. U mor me dialektologjinë, morfologjinë, fjalëformimin, sintaksën dhe leksikun e shqipes, duke shfaqur interes për gjuhën e folur dhe të shkruar. U doktorua më 1972 me temën “Mënyrat e shprehjes së lidhjes atributive në gjuhën shqipe” (Sposoby vyraženiya atributivnosti v albanskom jazyke). Mori pjesë në ekspedita shkencore në fshatrat shqipfolëse në Ukrainë dhe së bashku me M. Domosileckajan dhe L. Sharapovën përgatiti monografinë “E folmja e shqiptarëve të Ukrainës”, që u botua shqip më 1986. Në bashkëpunim me V. Modestov përktheu në gjuhën ruse veprat “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zyllo” të D. Agollit (1991) dhe “Dimri i madh” të I. Kadaresë (1992). Për kontributin e saj në zhvillimin e albanologjisë u dekorua me urdhrin “Naim Frashëri” nga qeveria e Republikës së Shqipërisë. (Marija Morozova)

VOSHTINA Luan (1930-). Inxhinier, profesor. Lindi në Fier të Shqipërisë. Mbaroi shkollën e mesme në Tiranë dhe më pas, më 1953, u diplomua për inxhinieri mekanike në Bukuresht (Rumani). Një kohë punoi në Institutin Politeknik të Tiranës dhe më vonë në Fakultetin e Inxhinierisë të Universitetit të Tiranës. Ishte titullar në lëndët: pjesa termike e centraleve termoelektrike, termo-teknikë dhe



LUAN VOSHTINA

termodinamikë, ngrohje-ventilim dhe klimatizim. Në Fakultetin Teknik të Universitetit të Prishtinës ka ligjëruar lëndët termodinamika teknike (1970-1974), impiantet e ftohjes (1980) dhe menaxhimi dhe prodhimi i kombinuar i energjisë (2004-2006). Ka botuar tekstet: “Termoteknika” I dhe II, “Termoteknika, ngrohja dhe ventilimi i ndërtesave” (3 vëllime) dhe është bashkautor i teksteve “Turbinat me avull”, “Impiantet termoenergetike”, “Fizika teknike” etj. Në vitin 2005 ka botuar në Prishtinë ligjëratat për Universitetin Veror të Prishtinës “Prodhimi i kombinuar i energjisë dhe ngrohja në largësi”, ndërsa më 2006 po në Prishtinë botoi librin: “Menaxhimi dhe prodhimi i kombinuar

i energjisë”. Ka marrë pjesë në konferenca të ndryshme shkencore brenda dhe jashtë vendit dhe është autor dhe bashkautor në projekte dhe zbatime në fushën e prodhimit të qymyrit aktiv, të impianteve të ngohje-klimatizimit dhe termofikimit, të prodhimit të fosforiteve, të impianteve të ftohjes industriale etj. Është nderuar me çmime dhe mirënjohje. (Fejzullah Krasniqi).

VRANICA Sylen (1949-). Mjek, neuropsikiatër, profesor universiteti. Lindi në Prizren, shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, Fakultetin e Mjekësisë në Beograd (1975). Pas diplomimit u punësua në Qendrën Mjekësore në Prizren. Specializimin dhe studimet pasuniversitare i kreu në Zagreb, ndërsa tezën e doktoratës e mbrojti në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë (1987). Ndërkohë u zgjodh asistent dhe më pas mori titujt përkatës universitarë për lëndën e neuropsikiatrisë në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. Ishte shef i katedrës, drejtor i klinikës neurologjike dhe ligjërues i studimeve pasuniversitare në Fakultetin e Psikologjisë në Tetovë. Është autor dhe bashkautor i një sërë punimesh shkencore dhe profesionale dhe autor i një teksti për narkomaninë. Është kryetar i Shoqatës së Neurologëve të Kosovës. (Xhavit Bica)

VRANIQI Veli (1936-1993). Gazetar i sportit. Lindi në Prizren. Njihet si njëri ndër gazetarët e parë të sportit në Kosovë. Nisi karrierën si futbollist i “Lirisë” së Prizrenit. Në sajë të cilësive të tij në rolin e qendërmbrojtësit kaloi në radhët e Prishtinës, ku bëri paraqitje të dalluara. Një dëmtim i këmbës bëri që Veli Vraniqi të braktisë lojën e futbollit. Më pas iu përkushtua gazetarisë sportive, profesion që e ushtroi deri në ditët e fundit të jetës. Një kohë ishte gazetar dhe redaktor në të përditshmen “Rilindja” dhe më pas u bë gazetar në redaksinë e sportit në Televizionin e Prishtinës, ku për herë të parë bëri transmetimin e drejtpërdrejtë të ngjarjeve sportive. U shqua sidomos me komentimet e tij të futbollit dhe të boksit. V. Vraniqi, ishte edhe drejtor i KF “Prishtina” në një periudhë kur kjo skuadër bënte gara në ligën e parë federative të Jugosllavisë. (Besim Kajtazi)

VRAQEVA. Fshat i tipit të shpërndarë, 7 km në veriperëndim të Leposaviqit. Shtrihet në lartësi

mbidetare 725 m. Sipërfaqja e territorit të fshatit është 1425 ha, nga e cila 70% janë pyje, të tjerat livadhe dhe ara. Popullsia merret me blegtori ekstensive. Në veri kufizohet me fshatrat Treboviq dhe Bare, ndërsa në perëndim dhe në jug me fshatin Bare dhe territorin e Serbisë. Në vitin 2011 Vraqeve kishte 78 banorë, ndaj 20 banorëve në vitin 1921. (Bajram Kafexholli)

VRELLA E REVUÇËS. Burim në pjesën veriperëndimore të fushëgropës së Llapit, në lartësinë mbidetare prej 1,100 m, në rrëzat lindore të Kopaonikut, në lokalitetin Revuçë, në veriperëndim të Podujevës. Buron nga kontakti litologjiko-tektonik, mes serpentiniteve dhe gëlqerorëve të kretakut. Është burim karstik me ujë të ftohtë, me prurje të ndryshueshme gjatë vitit, me mesatare rreth 10 l/sek. Shërben për furnizim të popullsisë me ujë të pijes. Llogaritet si burimi kryesor i lumit të Revuçës. Hapësira rreth saj mbulohet kryesisht nga pyjet e dushkut. (Shpejtim Bulliqi)

VRELLA. Fshat i tipit të grumbulluar, 7 km në perëndim të Istogut. Shtrihet në lartësi mbidetare 1,300 m. Sipërfaqja e territorit të fshatit është 2,370 ha, shumica pyje, shumë më pak ara dhe livadhe. Popullsia merret kryesisht me blegtori ekstensive. Është vendbanim i vjetër antik, që dëshmohet nga gjetjet e ndryshme arkeologjike. Me emrin Ivrella është regjistruar në sallnamet e vilajetit të Kosovës të vitit 1893, 1896 dhe të vitit 1900. Derisa në vitin 1921 Vrella kishte 790 banorë, në vitin 2011 ajo ka 2,641 banorë. Është bashkësi lokale me zonën gravituese, e cila përfshin fshatrat Kaliqan, Prigodë dhe Sudenicë. Ka shkollën 9-vjeçare, stacionin shëndetësor, disa njësi tregtare dhe shërbyese etj. (Bajram Kafexholli)

VRENEZI Nait (1946-). Psikolog. Lindi në Prizren, ku kreu shkollën fillore dhe gjimnazin. Kreu studimet për psikologji të punës në Universitetin e Beogradit më 1969. Pas studimeve u punësua në Entin Krahinor për Politika Sociale, si bashkëpunëtor profesional dhe më vonë u zgjodh edhe drejtor i këtij institucioni. Ndërkohë u zgjodh ligjërues i psikologjisë sociale në departamentin e filozofisë dhe të sociologjisë të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës, ku dhe ligjëroi deri më 2011. Me hapjen e departamentit të psikologjisë në këtë fakultet, u angazhua si ligjërues për lëndët: psikologji sociale,



NAIT VRENEZI

bazat e psikologjisë së punës, psikologjia e orientimit profesional dhe për statistikë. Si psikolog ishte i angazhuar në një studim longitudinal (1986-1999) nga Universiteti i Kolumbisë, SHBA, rreth ndikimit të ambientit, përkatë-

sisht të pluhurit të plumbit në atmosferë në zhvillimin psikofizik të fëmijëve. Në vitin 1988 themeloi Shoqatën për Mbrojtjen e Ambientit dhe ishte kryetar i saj. Gjatë vitit 1998 ishte këshilltar i UNICEF-it për punëtori me fëmijët e traumatizuar nga ngjarjet e luftës në Prekaz dhe Likoshan. Më 2010 u bë bashkëthemelues i organizatës “Encompas”, ku vazhdon aktivitetin si mbikëqyrës profesional në projekte të ndryshme. (Erëblir Kadriu)

VRESHTARIA. Në kuadër të bujqësisë zë vend të rëndësishëm. Në Kosovë, në vitin 1923 u ngrit fidanishtja e parë amë me nënshartesa të hardhisë amerikane. Në vitin 1939 Kosova



VRESHTAT NË RAHOVEC

kishte më shumë se 3,000 ha vreshta, ndërsa maksimumi u arrit në rreth 10,000 ha në vitin 1990. Vreshtaria, si njëra prej degëve më të rëndësishme të bujqësisë, arriti zhvillim mjaft të lartë në periudhën ndërmjet viteve 1970-1990, kur për çdo vit zgjeroheshin sipërfaqet me vreshta, rritej prodhimtaria e rrushit dhe e verës, ndërsa realizimi i këtyre produkteve eksportohej edhe në tregjet e huaja europiane e më gjerë. Rajonet më të njohura me vreshta janë: Rahoveci, Prizreni, Suhareka, Gjakova dhe Peja. Me përpunimin e rrushit përftohet vera, që në kushte tona kryesisht eksportohet

ndërsa si nënprodukte të tjera të përpunimit janë: lëngu i rrushit, pijet e forta alkoolike, uthulla, rrushi i tharë etj. Kultivarët më të rëndësishëm të rrushit për tryezë janë: Afuzali, Thancet, Muskati i korrikut, Mbretëresha e vreshtave, Muskat Hamburg, Pllodinku i zi (Pllodinja), Sulltanina e bardhë, Shaslla; kultivarët për verëra të kuqe: Prokupa, Pino i zi, Game i zi; kultivarët për verëra të bardha: Zhillavka, Rizlingu italian, Mosllavak, Semion, Smedereva. (Agim Zajmi)

VRIONI Ali Mehmet (1842-1895). Atdhetar dhe pjesëmarrës i lëvizjes kombëtare, bashkëpunëtor i Abdyl Frashërit. Ka qenë pjesëmarrës i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe kryetar i degës së Lidhjes në Berat, anëtar i Shoqërisë së Stambollit, anëtar i Komitetit të Janinës, deputet i Beratit në Parlamentin e Perandorisë Osmane, mytesarif i Beratit më 1881. Bashkë me Abdyl Frashërin ndërmorën një mision diplomatik në vitin 1879. Vizituan disa kryeqytete të Fuqive të Mëdha, për të sensibilizuar çështjen shqiptare dhe për të siguruar përkrahje në arenën ndërkombëtare. Ata, ndër të tjera, i parashtruan Kongresit të Berlinit kërkesat shqiptare të Lidhjes së Prizrenit. (Teki Kurti)

VUÇITERNALIA Ibush (1886-1938). Prijës i çetave kaçake nga Prishtina e deri në Karadak të Shkupit. Lindi në Prishtinë. Mori pjesë në shumë aksione e beteja kundër ushtrisë dhe xhandarmërisë serbe, që nga viti 1912 e prapa. Më 1920 mori pjesë në Kuvendin e Murgllës, në cilësinë e udhëheqësit të çetave. Ishte anëtar i Komitetit të Kosovës. Nëna i vdiq në burgun e Nishit më 1920. Pas vrasjes së Azem Bejtës më 1924, me familjen dhe vëllezërit e tij u zhvendos në Shqipëri, në fshatin Shinavlash të Durrësit. Pushteti jugosllav ia konfiskoi tërë pasurinë familjare. Më 4 gusht 1938 u vra me tradhti, me porosi të shërbimit serb. Në vitin 1993 u dekorua nga presidenti i Shqipërisë. (Liman Rushiti).

VUÇITËRNA Sulejman (1898-1948). Lindi në Vushtrri. Si i ri u inkuadrua në lëvizjen kaçake. Në moshën 21 vjeçare (1919) xhandarmëria serbe në fshatin Vërbovc u përpoq ta arrestonte, por nuk ia doli. Xhandarët serbë ia dogjën kullën për të tretën herë dhe vëllanë e tij, Isuf Kastratin, hoxhë i fshatit, e gposën të gjallë.

Në vitin 1922, përmes Liqenit të Shkodrës ik në Shqipëri. Kreu Normalen e Elbasanit dhe pastaj shkollën ushtarake në Tiranë. Në Torino të Italisë mbaroi Akademinë ushtarake dhe specializimin në Grac dhe Vjenë të Austrisë. Ishte profesor dhe drejtor i Shkollës Ushtarake Mbretërore në Tiranë. Si oficer me gradën e kolonelit kontribuoi në ngritjen e kuadrit ushtarak. Në vitin 1941, bashkë me anëtarë të tjerë të Komitetit të Kosovës kthehet në Mitrovicë. Emërohet komandant i mbrojtjes së kufirit me Malin e Zi dhe Serbinë. Ishte udhëheqës i forcave kombëtare për mbrojtjen e popullsisë shqiptare dhe boshnjake në Kolloshin, Bihor, Novi Pazar etj. nga vjeshta e vitit 1941 deri në vjeshtë të vitit 1944 kur kthehet në Shqipëri. Më 14 nëntor 1944 arrestohet nga komunistët e Tiranës dhe dënohet me 30 vjet burg dhe punë të detyruar. Përjeton vuajtje nga puna e rëndë fizike në kampin e Vloçishtit (ish-këneta e Maliqit). Aty propozet sa kishte ende shenja jete, më 15 tetor 1948. (Xheladin Shala)

VUÇITËRNI Zejnullah Bej (1869-1915). Veprimtar i çështjes kombëtare shqiptare. Lindi në Vushtrri. Me Hasan Prishtinën ishin djem të dy vëllezërve. Kontaktet e Hasan Prishtinës me patriotë të tjerë të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare i bënte Zejnullah bej Vuçitërna. U dallua në luftë kundër forcave osmane në Kosovë. Përmes autoritetit të tij u bëri thirrje popullit për kryengritje të armatosur. Investoi në armatosjen e kryengritësve shqiptarë në Kosovë. Së bashku me Hasan Prishtinën, më 5 maj të vitit 1912 dolën në krye të kryengritjes së armatosur në Drenicë dhe pastaj vazhduan në drejtim të Mitrovicës. Në Kuvendin e Junikut 1912, rajonin e Vushtrrisë e përfaqësoi Z. Vuçitërna. (Luan Tetaj)

VUÇKOVIQ (Vučković) Lazar (1937-1966). Poet i letërsisë serbe nga Kosova, gazetar. Ishte gazetar i gazetës “Jedinstvo” dhe njëri nga poetët e parë serbë në Kosovë pas Luftës së Dytë Botërore. Shkroi tregime dhe reportazhe poetike, të cilat i botoi në “Jedinstvo” dhe “Stremljenja” në Prishtinë. U mbyt në Liqenin e Ohrit (1966), ku ishte pjesëmarrës në “Mbrëmjet Strugane të Poezisë”. Është meritë e tij që për shumë vjet u mbajtën takimet e shkrimtarëve serbë të Kosovës, ndërsa revista letrare “Stremljenja” ndante çmimin letrar me emrin e tij. Botoi veprat: “Prekja e verës”

(1962), “Deti i humbur” (1966), ndërsa pas vdekjes poezitë e tij u ribotuan në Prishtinë dhe Beograd. Më 1966 poezitë e tij u përkthyen në gjuhën shqipe dhe u botuan nga “Rilindja”. (Ismet Marković)

VUJOVIQ Uglesha (Ugleša Vujović) (1947-). Aktor. Lindi në Ferizaj, ku mbaroi shkollën fillore dhe të mesme. Në Teatrin Popullor Krahinor (TPK) filloi punë si aktor në vitin 1971. Ishte aktor me vokal karakteristik dhe të fuqishëm, i cili gjatë karrierës së tij realizoi një sërë rolesh, shumica role kryesore. U veçua në shfaqjet: “Patrioti” (i shpërblyer për rolin më të mirë në Takimet Teatrore “Joakim Vujiq në Zajeçar të Serbisë, 1980), “Pelino”, “Varreza për Boris Davidoviçin”, “Otel” etj. Ka qenë i angazhuar edhe me role episodike në filmat e “Kosovafilmit”: “Kur pranvera vonohet”, “Gjurmë të bardha”, “Njeriu prej dheu” etj. Gjatë viteve ‘80 ishte drejtor i Dramës Serbe të TPK-së. Për punën e tij në skenë mori çmime dhe mirënjohje. (Fadil Hysaj)

VUKMANOVIQ-TEMPO Svetozar (1912-2000). Funkionar i lartë komunist jugosllav, gjeneralnënkolonel, hero i popullit. Lindi në Podgora (Tivar, Mali i Zi). Shkollimin fillor e përfundoi në vendlindje, të mesmin në Cetinë, ndërsa Fakultetin Juridik në Beograd (1935). Që më 1932 u bë anëtar i organizatës së rinisë komuniste (SKOJ) dhe një vit më vonë anëtar i Partisë Komuniste të Jugosllavisë (PKJ). Në vitet para të Luftës së Dytë Botërore, për shkak të aktivitetit komunist, u burgos disa herë. Ishte anëtar i komitetit për Beogradin dhe anëtar i komitetit për Serbi të PKJ-së. Në Konferencën V të PKJ-së (1940) u zgjodh anëtar i Komitetit Qendror (KQ) të PKJ-së. Ishte instruktor i KQ-së dhe një kohë punoi në teknikën partiake të PKJ-së. Ishte njëri nga organizatorët e kryengritjes antifashiste në vitin 1941, më pas ishte delegat i Komitetit Qendror të PKJ-së dhe i shtabit suprem në Bosnjë e Hercegovinë etj. Një kohë ishte gjithashtu i dërguar i Komitetit Qendror të PKJ-së dhe i shtabit kryesor të Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Jugosllavisë për Maqedoni, Kosovë dhe për një pjesë të Serbisë, ku pati një rol me rëndësi në bashkëpunimin në mes PKJ-së me Partinë Komuniste të Shqipërisë, të Greqisë dhe të Bullgarisë. Pas lufte ishte kryeshef i Drejtorisë Kryesore Politike të Armatës Popullore të Jugosllavisë,


ndihmësministër i Mbrojtjes Popullore, ministër në qeverinë federative, nënkryetar i Këshillit Ekzekutiv Federativ etj. Botoi disa libra me kujtime për luftën, si: “Revolucioni që rrjedh” (1971), “Lufta për Ballkanin” (1981) etj., në të cilat, ndër të tjera, mbronte tezën se Partinë Komuniste të Shqipërisë e kishte themeluar Partia Komuniste e Jugosllavisë. (Blerim Haziri)

VUKOVIQ (Vuković) Vladeta (1928-2003). Shkrimtar i letërsisë serbe nga Kosova, profesor universiteti, akademik. Lindi në Vërnjačka Banjë. Kreu letërsi jugosllave dhe gjuhë serbokroate në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Beogradit. Ishte ligjërues në Shkollën e Lartë Pedagogjike dhe në Fakultetin Filozofik në Prishtinë, që nga themelimi i tij më 1960). Mbrojti disertacionin e doktoratës në Fakultetin e Filologjisë në Beograd (1965). Filloi të botojë poezi dhe kritikë letrare që pas Luftës së Dytë Botërore. Botoi përmbledhjet e poezive: “Nga shtigjet e Goçkës” (1954), “Yjet ngrohën me agim” (1959), “Fjalët dhe zogjtë” (1964), “Shuarja e gurgullimave” (1966), “Yjet e fëmijërisë” (1973), “Gjurmëve të zërit” (1973), “Memento” (1978), “Vjersha” (1997) “Do mbetem diku” (1997). Botoi edhe një sërë librash me kritika letrare ese dhe artikuj studimorë për letërsinë serbe. Ishte anëtar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. (Ismet Marković)

VUKPALAJ Anton (1971-). Politikolog, mësimdhënës universiteti. Lindi në Tuz të Malit të Zi. Shkollimin fillor dhe të mesëm i përfundoi në Tuz. Kreu studimet për shkencat politike dhe integrimet europiane në Universitetin e Sorbonës (1994-1999), në Universitetin “Paris 10” (1999-2004) dhe në Institutin e Shkencave Sociale të Politikës në Paris (2004-2008). Punoi si asistent në Universitetin “Paris 10”, ku ligjëroi lëndën shtetet e Mesdheut. Më 2011 filloi punën në departamentin e shkencave politike të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës (UP), ku ligjëron për integrimet europiane, për politikën krahasuese, për transicionet demokratike dhe politikat krahasimtare të Ballkanit. Ka të botuar artikuj shkencorë dhe hulumtime, kryesisht mbi Ballkanin Perëndimor. Teza e tij e doktoraturës për Gjykatën Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë është botuar në Francë. Një kohë punoi si bashkëpunëtor i pavarur shkencor

në Institutin e Shkencave Sociale të Politikës (ISP) në Paris, e më vonë edhe anëtar i rregullt i tij. Gjithashtu ishte bashkëpunëtor shkencor i grupit për analiza politike (GAP) në Universitetin e “Parisit 10”. Punon në departamentin e shkencave politike të Fakultetit Filozofik të UP-së. (Alfred Marleku)

VULA Agron (1960-). Montazher, regjisor. Lindi në Mitrovicë. Shkollën fillore e përfundoi në Mitrovicë, shkollën e mesme në Prishtinë, ndërsa studimet universitare dhe



AGRON VULA

pasuniversitare në Akademinë për Film dhe Teatër në Zagreb. Nga viti 1983 e deri në vitin 1990 punoi montazher dhe shef i montazherëve në TVP. Nga viti 1990-1991 punoi si montazher në “Offener Canal” në Berlin, pastaj në TD1 (TV Turk) po në Berlin (1991-1994), si drejtor i produksionit, ndërsa në vitin 1994 kalon në Televizionin Shqiptar. Në periudhën 1996-2000 punoi si montazher në Radion “Deutsche Welle”, në seksionin botëror të lajmeve. Nga viti 2000 deri më 2015 ishte ligjërues në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës dhe njëkohësisht drejtor i produksionit në RTV-21 dhe montazher e regjisor televiziv. Ka bërë montazhin e filmave artistikë: “Lepuri me pesë këmbë”, “Proka”, “Njeriu prej dheu”, “Pikniku”, “Rojet e mjegullës”, “Kukumi”, “Anatema”, “Gomarët e kufirit”, “Agnus Dei”, “Tri dritare dhe një varje” etj. A. Vula ka bërë regjinë dhe realizimin televiziv të shumë spektakleve dhe festivaleve. (Ibrahim Berisha)

VULA Blerim (1953-). Gazetar i sportit. Lindi në Gjakovë. Në rini të hershme ishte basketbollist. Filloi të merret me gazetari që në vitin 1974 dhe dy vjet më vonë u bë gazetar i “Rilindjes”, ku punoi deri në mbyllje të saj (shkurt 2002). Më vonë punoi për gazetën “Lajm” dhe që nga viti 2006 punon për të përditshmen “Kosova sot”. Shkrime për sportin ka botuar edhe në gazetën e tjera të Kosovës (“Sport”, “Bota e re”, “Zëri”, “Kosova sport” etj.), sikundër që ishte autor i raporteve dhe reportazheve sportive për Radio-Gjakovën, Radio-Dukagjinin, Radio-Prishtinën etj. Si gazetar ndoqi një numër ngjarjesh të

rëndësishme sportive, veçmas kampionatet europiane dhe botërore të basketbollit, pastaj shumë ndeshje ndërkombëtare të futbollit dhe të basketbollit në nivel të përfaqësueseve dhe të skuadrave. U angazhua edhe në organizime të ndryshme sportive, duke dhënë një kontribut të çmuar veçmas në krijimin e institucioneve dhe të asociacioneve të pavarura të sportit në Kosovë pas vitit 1991. (Lulzim Shala)

VULA (BUÇINCA) Xheraldina (1963-). Gazetare. Lindi në Vushtrri. Shkollën fillore dhe të mesme i përfundoi në Vushtrri, ndërsa studimet për letërsi dhe gjuhë shqipe në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Prishtinës. Gjatë viteve '90 ishte bashkëthemeluese e organizatave joqeveritare në fushën e arsimit dhe medias, e Shtëpisë Botuese "Lura" dhe bashkëthemeluese dhe bashkëpronare e RTV-21 (1998) dhe TV-21 në Maqedoni (2015). Është zëvendësdrejtoreshë në RTV-21. Është aktiviste për barazi gjinore dhe bën trajnime në fushën e gazetarisë televizive dhe të mjeshtrive të komunikimit. Në kuadër të programeve televizive është autore dhe udhëheqëse e shumë programeve televizive me shikueshmëri të lartë. Shkruan poezi. Ka botuar përmbledhjet: "Megjithatë sillet" (1988), "Me bisht syri" (1995), "Ritual me pantallona" (2000) etj. (Ibrahim Berisha)

VULIQ Nikolla (Nikola Vulić) (1872-1945). Arkeolog serb, filolog klasik, muzeolog. Lindi në Shkodër, arsimimin e kreu në Serbi, të mesmen në Zaječar dhe studimet në Beograd. Specializimin për historinë e vjetër, arkeologjinë, epigrafinë, paleografinë dhe filologjinë klasike i kreu në Munihi (Gjermani), ku edhe doktoroi (1896). Punoi si profesor i historisë së kohës së vjetër në Shkollën e Lartë të Beogradit (1897) dhe pastaj në Universitetin e Beogradit (1919). Ishte kryetar i "Shoqatës serbe të arkeologëve", redaktor i revistës "Starinar" (1922-1931), kryetar i Shoqatës së Historianëve të Serbisë, anëtar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Serbisë (1921), anëtar i Unionit Ndërkombëtar të Akademive dhe anëtar korrespondent i disa akademive nacionale dhe i institutëve kombëtare të arkeologjisë në Vjenë, Berlin etj. Bëri kërkime arkeologjike dhe botoi shumë artikuj studimorë në revista shkencore. Shquhet për kontributin e dhënë për studimin e kulturës materiale ilire dhe kontributin në fushën e epigrafisë. (Arben Hajdari)

VULLKANET. Vrimë e rrumbullakët ose në trajtën e një të çare, nëpër të cilën vazhdimisht ose kohë pas kohe kanë dalë ose vazhdojnë të dalin produkte të veprimtarisë vullkanike, nga thellësia mbi sipërfaqen e Tokës. Shpesh me termin vullkan kuptohet një pjesë e ngritur, kupa e vullkanit, zakonisht me krater në majë, që është formuar nga produktet e shpërthimit (lava, materialet piroklastike, gazrat). Në majën e vullkanit ndodhet gryka ose krateri që ka formën e një hinke me përmasa të ndryshme, nga ku del lava me produktet e tjera në sipërfaqe. Vullkanet mund të jenë aktivë ose të shuar. Në Kosovë, në terciar, më së shumti ka pasur një aktivitet të fuqishëm vullkanik, i shprehur veçanërisht në rajonin e Mitrovicës dhe të Podujevës, ku janë të pranishme shumë kupa vullkanike (Kupa e Zveçanit), ose pjesë të tyre të ruajtura (Melenicë) dhe rrjedhjeve të lavës (Vllahi, Barilevë). (Gani Maliqi)

VUNIQI Blerim (1956-). Basketbollist, gazetar i sportit. Lindi në Prishtinë, ku kreu shkollimin fillor, të mesëm dhe universitar. Karrierën sportive e filloi si basketbollist. Luajti për disa skuadra të basketbollit në Kosovë ("Elektrici", "Elektroekonomia" dhe "Prishtina"), me të cilat fitoi shumë tituj e trofe. Pas përfundimit të karrierës aktive ishte anëtar i kryesisë së Federatës së Basketbollit të Kosovës dhe trajner i klubit të basketbollit të femrave "Universiteti". Si gazetar i sportit nisi të punonte në Radiotelevizionin e Prishtinës, pastaj në gazetën "Sport plus", në RTV 21 dhe që nga viti 2003 është redaktor përgjegjës i redaksisë së sportit në Televizionin e Kosovës. Gjatë karrierës si gazetar ndoqi shumë ngjarje sportive nga futboli, basketboli dhe boksi profesionist. (Edmond Thaçi)

VUSHTRRIA. Qytet në pjesën veriore të Kosovës dhe qendër e komunës me të njëjtin emër. Shtrihet në bregun e djathtë të lumit Sitnicë, në dy anët e rrugës Prishtinë-Mitrovicë, në lartësi mbidetare 500 m. Ka pozitë të volitshme gjeografike, ngase shtrihet në pjesën veriore të fushëgropës së Kosovës, ndërmjet dy qyteteve të mëdha, ku gërshetohen linja të rëndësishme rrugore që nga antika, të cilat kanë luajtur rol të rëndësishëm gjatë historisë në formimin dhe zhvillimin e kësaj qendre. Nëpër Vushtrri tani kalon rruga e rëndësishme rajonale Mitrovicë-Prishtinë-Ferizaj. Kjo rrugë, në drejtim të



VUSHTRRIA

veriut, vazhdon nëpër luginën e Ibrit, duke lidhur Kosovën me Europën Qendrore dhe atë Perëndimore. Vushtrria është njëra nga qendrat më të vjetra urbane në Kosovë, e ngritur në lokacionin e vendbanimit antik Vicianum. Viteve të fundit rreth kalasë janë zbuluar themelet e fortifikatës antike, që e vërtetojnë lashtësinë e saj. Kalaja kishte funksion mbrojtës edhe gjatë periudhës osmane. Ndërsa në anën veriore të Vushtrrisë gjenden gërmadhat, të cilat nga banorët edhe sot quhen qytet. Në lokalitetin e këtij vendbanimi janë gjetur mbishkrime latine të kohës së sundimit romak. Vushtrria nga fundi i shek. XIV dhe fillimi i shek. XV ishte qytet me tregti të zhvilluar. Si qendër e rëndësishme urbane, administrative dhe tregtare, nga periudha e mesjetës ruan edhe vlera të rëndësishme arkitektonike, si ura, banja, çesme, mullinj etj. Në sajë të pozitës së përshtatshme geografike dhe funksioneve administrative e ushtarake gjatë sundimit osman, Vushtrria bëhet qyteti më i madh në Rrafshin e Kosovës. Ajo përmendet si seli e sanxhakut në vitin 1462. Në shek. XVI, Vushtrria cilësohet si qendër e madhe tregtare me dyqane dhe bujtina të shumta. Sipas udhëpërshkruesit J. Miler, në vitin 1834 Vushtrria kishte 470 shtëpi me 5,000 banorë, kurse sipas sallnames së vitit 1900, kishte mbi 1,000 shtëpi dhe 5,800 banorë. Në vitin 1948 Vushtrria kishte 1,181 shtëpi me 5,813 banorë, në vitin 1981 kishte 3,246 shtëpi me 20,329 banorë, ndërsa sipas regjistrimit të fundit (2011) qyteti ka 27,272 banorë. Vushtrria dallohet me objekte të antikitetit dhe objekte të shumta të arkitekturës orientale, me rrugë të ngushta e të shtruara me kalldrëm, hamamin e vjetër, shtëpi të banimit të rrethuara me mure e me kopshte etj. Në gjysmën e dytë të shek. XX

Vushtrria përjetoi një zhvillim të rëndësishëm ekonomik në disa degë industriale, si metalike, të konfeksionit, kimike, të ndërtimtarisë, tregtare, bujqësore etj. Gjatë luftës së fundit u vranë shumë banorë dhe u shkatërruan shumë objekte kulturore-historike dhe shtëpi banimi. Ekonomia e saj tani po rimëkëmbet përmes ndërmarrjeve të vogla e të mesme tregtare, ndërtimore e bujqësore. (Skënder Halimi)

VUSHTRRIA (komuna). Shtrihet në pjesën veriore të Kosovës, në formë pak të zgjatur në drejtimin veri-jug, me gjatësi 34 km dhe gjerësi maksimale rreth 23 km. Pjesa jugperëndimore (Çiçavica), pjesa veriore dhe verilindore e territorit të komunës (Kopaoniku), karakterizohet me relief kryesisht kodrinor-malor, kurse pjesa qendrore dhe juglindore është fushore. Në veri kufizohet me komunën e Mitrovicës, në lindje me Podujevën, në jug me Obiliqin, në jugperëndim me Drenasin dhe në perëndim me Skënderajin. Sipërfaqja e territorit të komunës është 345 km² (3.3% të territorit të Kosovës), numri i vendbanimeve është 67, kurse dendësia e popullsisë 202 b/km². Përmes territorit të komunës kalon rruga kryesore automobilistike e Kosovës dhe hekurudha që lidh Prishtinën me Mitrovicën e më tej. Ka klimë kontinentale, e cila karakterizohet me vera të nxehta, me dimra të ftohtë dhe me reshje më të shumta gjatë stinës së pranverës. Sa i përket hidrografisë, nëpër territorin e komunës së Vushtrrisë rrjedh lumi Sitnica me disa degë të saj dhe me rrjedhjen e poshtme të lumit Llap. Lumi Sitnica në territorin e komunës së Vushtrrisë, nga ana e djathtë, merr këto degë kryesore: lumin Llap, lumin e Samadrexhës, Lumkuqin, Trestenkën dhe përroin e Smrekonicës. Lumi Sitnica dikur ishte shumë afër qytetit të Vushtrrisë, që e dëshmon Ura e Gurit, mirëpo pas vërshimeve të mëdha që ndodhën në shek. XVIII, ndërroi shtratin për disa qindra metra në perëndim. Territori i komunës së Vushtrrisë veçohet me pasuri minerale dhe shtresa linjiti. Territori i kësaj komune ishte i banuar shumë herët, gjë që e dëshmojnë gjetjet e shumta arkeologjike, si rrënojat e vjetra në Duboc, Stroc, Smrekonicë, Samadrexhë dhe qyteti antik Vicianum në Vushtrri. Në bazë të regjistrimit të takspaguesve të vitit 1462, dëshmohet se Vushtrria ishte qendër e sanxhakut që kishte një territor relativisht të madh, duke përfshirë Llapin, Obrovcin e Epërm, Prishtinën, Moravën dhe

Topollnicën. Nga viti 1878, me dëbimin e popullsisë shqiptare nga sanxhaku i Nishit, në shumë vendbanime të komunës së Vushtrrisë u vendosën rreth 11,000 muhaxhirë, kurse gjatë reformës agrare të viteve '20 dhe '30 të shekullit të kaluar, në territorin e komunës u vendosën rreth 7,000 kolonë serbë. Në anën tjetër, nga dhuna serbe, u shpërngulën mbi 8,000 shqiptarë për në Turqi. Sipas regjistrimit të vitit 1948, komuna kishte 5,447 ekonomi familjare me 35,530 banorë. Sipas regjistrimit të vitit 1981, komuna kishte 65,512 banorë. Me regjistrimin e fundit (2011) në komunën e Vushtrrisë jetojnë rreth 70,000 banorë. Gjatë luftës së fundit (1998-99), komuna e Vushtrrisë pësoi dëme të mëdha në njerëz, objekte dhe ekonomi.

Nga aspekti ekonomik, komuna e Vushtrrisë dallohet për kultivimin e drithërave të bukës, foragjereve, e sidomos për kultivimin e patates. Sipërfaqja e tokës së punueshme është rreth 16,000 ha, gjysma e së cilës është e përfshirë në sistemin e ujitjes. Industria fillon të zhvillohet në gjysmën e dytë të shek. XX, me disa degë të rëndësishme, si industria metalike, e konfeksionit, kimike, e ndërtimit etj. Rrjetin shkollor e përbëjnë 22 shkolla fillore, dy të mesme dhe Shkolla e Ministrisë së Punëve të Brendshme (shkolla e policisë). Objektet me vlerë kulturore-historike, pasuritë minerale, tokat pjellore etj., ofrojnë mundësi të shumta për zhvillim të gjithëmbarshtëm ekonomik-shoqëror. (Skënder Halimi)

X

XEHERORET E PERIUDHËS OSMANE.

Në fillim të vendosjes së sundimit osman në Kosovë xehetaria përjetoj rënie të përkohshme. Mirëpo, duke e parë rëndësinë e eksploatimit të xeheroreve të pasura të Ballkanit (sidomos të Kosovës) për ekonominë osmane dhe ushtrinë e saj në ekspansion, sulltanët osmanë (Mehmeti II, Bajaziti II dhe Sylejmani Ligdhënës) u përpoqën që nëpërmjet ligjeve speciale mbi xeheroret ta përparonin sa më shumë këtë degë të ekonomisë. Në këtë kontekst e drejta e shfrytëzimit dhe e punës në xeherore iu njoh edhe raguzanëve (dubrovnikasve) edhe minatorëve sasë, të cilët e ushtronin këtë profesion në xeheroret e Kosovës edhe para ardhjes së osmanëve.

Përgjithësisht nga xeheroret e Kosovës gjatë sundimit osman nxirrej plumbi, argjendi, ari, hekuri, bakri, shalitra, shapi etj. Plumbi nxirrej kryesisht nga xeheroret e zonës së Kopaonikut: Trepça, Zapllanina, Pllana, Bellasica (Kosova), Bërveniku, Belloberda dhe Rrëzhana. Plumbi nxirrej edhe nga xeheroret e Novobërdës dhe të Janjevës. Sipas burimeve osmane të shekujve XV e XVI, xeherore të plumbit kishte edhe në zonat xehetare të kazave të Shkupit, Prishtinës dhe Vuçitërnës. Argjendi nxirrej në sasi shumë të mëdha nga xeheroret e Novobërdës, Janjevës e Trepçës, zonë xehetare, që në burimet e kohës quhej “Mal i argjendit” (Montagne d’argent, Gumus dagi). Me ligjin osman mbi xeheroret i vitit 1536, Trepça gjendej në listën e xeheroreve më të rëndësishme të argjendit në Rumeli. Burimet osmane përmendin nxjerrjen e argjendit edhe në Prizren dhe në Fandë të Shqipërisë. Nga xeheroret e arit, të njohura që nga mesjeta, shquheshin sidomos xeheroret e Novobërdës, Janjevës dhe Trepçës. Një burim perëndimor i vitit 1685 flet mbi xeheroret e arit dhe të argjendit në rrethet e Shkupit. Eksploatimi i xehes së hekurit përmendet në zonën xehetare të Kopaoni-

kut, por edhe në xeheroren e Altinit në pronën e Manastirit të Deçanit. Xehja e bakrit, shumë e kërkuar për prodhimin e topave, për prerje të monedhave (mangir), si dhe për amvisëri nxirrej në Pukë. Shalitra, e domosdoshme për prodhimin e barotit, nxirrej në trevat e Shkupit dhe të Prishtinës. Për xeherore të shapit, shumë i nevojshëm sidomos për zejen e kallajxhinjve, nuk ka shënime për shekujt XV-XVIII, por në shekullit XIX përmenden xeheroret e shapit në Shkup, Manastir etj. Farkimi i monedhave bëhej në taraphane dhe kjo veprimtari nuk ishte e kufizuar vetëm në kryeqytet të perandorisë, por lejohej edhe në shumë xeherore të rëndësishme të argjendit e të arit. Në Rumeli u dalluan taraphanet e Novobërdës, Shkupit, Kratovës etj., ku preheshin monedhat e arit (filuret), të argjendit (akçet), por edhe të bakrit (mangiret).

Osmanët aplikuan në xeheroret e Kosovës teknikën dhe shumë rregulla të punës të trashëguara nga sasët. Në këto xeherore punonin kryesisht banorët e fshatrave të afërta me xeheroret. Ata ishin të detyruar të punonin në xeherore si minatorë, qymyrxhi apo druvarë. Mirëpo, kjo u shpërblehej me një sërë privilegjesh (lirim nga shumë taksa e detyrime si dhe nga rekrutimi në jeniçer me sistemin e devshirmes).

Nxjerrja e arit, argjendit dhe metaleve të tjera nga xeheroret e Kosovës vazhdoi deri në gjysmën e dytë të shekullit XVII, kur luftërat austro-osmane (1683-1699) i dhanë një grusht të fortë xehetarisë në përgjithësi. Në mesin e shekullit XVII shumë xeherore e ndërprejnë tërësisht ose pjesërisht punën. Rënies së xehetarisë i ndihmoi edhe fakti se Perandoria Osmane nuk arrinte t’i bënte ballë konkurrencës dhe zhvillimit të hovshëm të ekonomisë së shteteve koloniale dhe industriale të Europës. (Gazmend Rizaj)

XEHETARIA ANTIKE. Degë e ekonomisë nga epoka e eneolitit. Xehetaria kishte rol të madh edhe në ekonominë dardane. Dardanët si xehetarë vepruan edhe në Daki e gjetiu. Xehetaria mori hov me zhvillimin e veprimtarive zejtare dhe ndër prodhimet më të njohura në botën antike u bënë sidomos rrathët dardanë prej ari dhe armët mahaira. Romakët vazhduan eksploatimin e minierave ekzistuese dhe hapën të reja. Krahinat xehetare në Kosovën antike ishin ajo e Kopaonikut, Artanës, Karadakut, Moknës, ndërsa vendbanimet më të rëndësishme pranë xeheroreve ishin “Lama e Artë” (Novobërdë), Veletini (Janjevë) e Municipium D Dardanorum (Soçanicë). Në këtë të fundit u prenë dhe monedhat e veçanta me mbishkrimin “Dardanici”. (Sefer Lajçi)

XEHETARIA DHE MINIERAT MESJETARE. Xeheroret e Kosovës, disa prej tyre që nga periudha antike, ishin ndër xeheroret më të njohura europiane gjatë periudhës së mesjetës. Xehetaria dhe xeherorët në Kosovë ishin të njohura që nga periudha pararomake. Shpëlarja e arit nga lumenjtë ishte traditë ilire në anën e Prizrenit. Në kohën e perandorit Trajan (98-117) në Janjevë dhe Kishnicë u hapën galeritë e para të xeherores së plumbit dhe të argjendit. Janë të njohura edhe minierat e trevës së Ulpianës, ku punonin kryesisht sklevër dhe profesionistë.

Gjatë mesjetës minierat u shfrytëzuan së pari nga popullsia vendore dhe më pas nga zotërues të Bizantit, të Rashës, të Raguzës dhe të Venedikut. Në shek. XIV-XV u bënë të njohura xeheroret e argjendit, të arit dhe plumbit në Trepçë dhe në zonën e Kopaonikut. Argjendi dhe ari i llojit më të kërkuar në Europë nxirrej në Novobërdë dhe Janjevë. Xeherore më të vogla të plumbit kishte edhe në zonën e Prishtinës, si në Kishnicë, apo të argjendit në afërsi të Prizrenit, Ndërkaq, xeherore hekuri kishte dhe në zonën e Deçanit. Ishte i njohur argjendi i përzier me sasi më të vogël ari (*argentum de gllama*) nga xeheroret e Novobërdës, Trepçës dhe Janjevës. Deri në zbulimin e Amerikës, xeheroret e Kosovës ishin ndër më të njohurat në Europë. Xeheroret mesjetare në Kosovë kishin edhe ligjet e tyre, me të cilat rregulloheshin marrëdhëniet pronësore-juridike. Në këto xeherore u sollën edhe minatorë sasë të dalluar në këtë profesion gjatë shek. XIII-XV, si në Novobërdë, Trepçë e Janjevë, ku vepronin edhe famullitë e tyre

katolike. Sasët sollën me vete edhe ekspertizën e shkrirjes së metaleve dhe të farkimit të monedhave. Në qytete xehetare u krijuan edhe kolonitë tregtare të Raguzës e të Kotorrit. Xehet e minierave të Kosovës, sidomos argjendi, eksportohehin nga raguzanët në Hungari, Venedik dhe në qytetet e tjera italiane dhe prej andej në tregje të pasura europiane. Edhe plumbi, si metal shumë i kërkuar në gjysmën e parë të shek. XV, eksportohej nëpërmjet raguzanëve në Venedik dhe tutje në Spanjë, Aleksandri dhe Siri. Raguzanët, krahas tregtisë njiheshin në raste të caktuara edhe si pronarë dhe bashkëpronarë të galerive në zonat xehetare të Kosovës. Republika e Raguzës hapi edhe konsullatat e saj në Trepçë, Janjevë, Novobërdë, Bellasicë etj., të cilat merreshin edhe me çështje ekonomike, kryesisht në mbrojtje të interesave të tregtarëve raguzanë. Megjithatë, pas Betejës së Dytë të Kosovës (1448) dhe pas rënies përfundimtare të Kosovës nën osmanët (1455), numri i raguzanëve dhe i sasëve në qytete të Kosovës nisi të bjerë, sepse administrata osmane e ndaloi eksportin e metaleve fisnike të xeheroreve të Kosovës. Megjithatë, kolonitë e tyre ishin të pranishme në Kosovë, ndonëse në numër më të vogël. Xeheroret më të njohura të Kosovës e vazhduan jetën e tyre edhe në kohën e sundimit osman, ndonëse jo me intensitetin e dikurshëm. (Gazmend Rizaj)

XËRXA Gemb (1983-). Piktore. Lindi në Gjakovë. Kreu shkollimin fillor dhe të mesëm në vendlindje, ndërsa studimet për pikturë në Fakultetin e Arteve në Prishtinë. Në pikturë trajton imazhe që duken plot zhurmë, imagjinative, dramatike, me forma të shkapërderdhura njëra mbi tjetrën. Hapi disa ekspozita personale në “Jakova Innovation Center” në Gjakovë (2015), në Muzeun Etnografik të Gjakovës (2010), në Galerinë e Arteve “Eduard Lir” në Berat (2010) dhe në Galerinë “Vizioni i ri 2000+” në Gjakovë (2008). Nga ekspozitat kolektive veçohen: “Tri gjenerata”, Muzeu i Kosovës (Prishtinë 2014); “Expo Diaspora” (Gjermani, 2014); ekspozita “Çmimi Muslim Mulliqi” (Prishtinë 2010); “Arte Moderna e Conterporanea” (Ferrara, 2010); “Rrugë pa fund” (Tiranë, 2006), ekspozita e konkursit ndërkombëtar në Gembloux (Belgjikë 2006) etj. Është fitues i disa çmimeve dhe i mirënjohjeve brenda dhe jashtë vendit. (Hajrush Fazliu)

XH

XHAFSA Sislej (1970-). Artist bashkëkohor. Lindi në Pejë. Në vitet 1994-1995 vijoi studimet në Kolegjin e Artit dhe Dizajnit në Minneapolis, SHBA, kurse më 1997 kreu studimet




SISLEJ XHAFSA NË BIENALEN E VENECIAS

në Akademinë e Arteve të Bukura në Firence të Italisë. S. Xhafa prek tema dhe dimensione nga jeta e përditshme, sociale, politike dhe ekonomike nëpërmjet medimeve të ndryshme bashkëkohore. Ka marrë pjesë në shumë ekspozita të rëndësishme ndërkombëtare: MAXXI Museum of CA, Romë Benvenuto! (2016); BWA Sokół CAG në Novi Saç, Poloni, The Stillness of Thought (2016); Harrova që fillova, Tiranë (2014); Pavioni Italian në Bienalen e 55-të të Venecias (2013); 21st Century MCA Kanzawa Borderline: CE II Kanazaua, Japoni (2013); GCU Bride Le Moulin (2012); FPF The World Belongs to You PG, Venecie; Hardau City Park, Y, Cyrih; Madre Donna Regina, Napoli; The Power Plant Toronto (2011); PRISM Misericordia West Hollywood, Kaliforni; MAXXI Spazio. DCAA, Romë; Il Museo Privato GAMEC, Bergamo; MART Rovereto Museo; PAC, Ibrido. Genetica delle forme, Milano; DEPO, Stamboll; MADRE Napoli (2009);

Havana Biennale, Kubë; MA Oxford TIB of Guanxhu, Kore; MOCAD, Business As Usual; Schirn Kunsthalle, All-Inclusive, A Tourist World, Frankfurt (2008); Istanbul MMA Time Present, Time Past; Göteborg International Biennial; MAM, All About Laughter Humor in CA, Tokio (2007); I Bienal de AC de Sevilla, Fundación BIACS, La alegría de mis sueños, MCSM de las Cuervas, Sevilla; The RS, New Video, New Europe, Çikago; MCA, St.Louis; Tate Modern, Londër; SM, Amsterdam, NDMA, Grand Forks; Fundació 'la Caixa' la SM, Barcelonë; HMA, Izrael (2004), Palais de Tokyo, Paris (2003), Guanxhu Biennial, Pause, (2002); Istanbul Biennial; S.M.A.K., Casino, Gent; PS1 Uniform New-York (2001); Manifesta III, Lubjanë, S.M.A.K., Over the Edges Gent (2000); Fondazione Olivetti, Romë (2000) dhe në Venice Biennale (1997, 1999, 2005 dhe 2013) etj. Jeton dhe punon në Nju-Jork. (Ilir Muharremi)

XHAFSA Xhevdet (1935-). Piktore. Lindi në Pejë. Kreu arsimin bazë dhe Shkollën e Mesme të Artit në Pejë, ndërsa Akademinë e Arteve Figurative, drejtimi i pikturës, në Lubjanë (1970). Nga viti 1970 është anëtar i Shoqatës së Artistëve Figurativë të Kosovës. Për shumë vjet punoi si mësimdhënëse në Akademinë e Arteve të Universitetit të Prishtinës (1974-2004), ku ligjëroi lëndën e pikturës. Ka hapur disa



XHEVDET XHAFSA

ekspozita personale: në Pejë, Prishtinë (2004); në Beograd, Salloni i Muzeut Bashkëkohor, Novi-Sad, Kragujevac, Nish (1973-1984); Galeria CCY, Paris (1985); Dubrovnik (1988)

dhe në Shkup (1996), pastaj në Muzeun e Kosovës në Prishtinë (2004). Mori pjesë në shumë ekspozita kolektive, brenda e jashtë vendit, në Sallonet Pranverore, Bienalet e Vizatimit organizuar nga SHAFK-u, si dhe në një sërë ekspozitash në botën e jashtme: më 1975 në Kanë (Francë), në ekspozitën “Arti ndërkombëtar” (Paris-Vjenë-Romë, Velington-Sidnej, 1977 /78), në ekspozitën e artistëve të ish-Jugosllavisë në Beograd (1980, 1987), në Bienalen e Artit Bashkëkohor në Sarajevë, në Trienalen e pikturës në Nju-Delhi (1982) dhe në qendra të tjera evropiane e botërore. Është fitues i disa çmimeve dhe mirënjohjeve: “Franc Preshern” nga Universiteti i Lubjanës (1971), çmimi kombëtar në Kanë (1975), çmimi për pikturë i Sallonit Pranveror të Kosovës (1974), mirënjohje nga Bienala e Pikturës në Nju-Jork (1980) dhe një sërë çmimesh të tjera. Veprat e tij gjenden në disa galeri e muze të artit bashkëkohor. Nga viti 2012 është anëtar korrespondent në Akademinë e Shkencave e të Arteve të Kosovës. Që nga cikli i parë, “Asociacione”, deri te “Autobiografia” Xh. Xhafa i është qasur me përkushtim realizimit të veprave monumentale, që shpërfaqin motivet dhe imazhet nga hapësira kosovare, duke u nisur nga tematika sociale e deri tek assemblazhet e realizuara në frymën e introduktit, të ekspresionizmit abstrakt dhe enformelit. Pikturat e tij nuk janë vetëm telajo të ngjyrosura, por edhe objekte që kanë simbolikën e vet, në të cilën secili mund ta gjejë pjesën e së kaluarës, apo ta mendojë e ta njohë të tashmen. Tablotë e Xhafës nuk kanë emra të veçantë, ato në tërësi krijojnë “shiritin” e madh të veprave artistike, që bëhen pjesë përbërëse e cikleve dhe fazave krijuese të emërtuar “Autobiografia”. Xhafa është përfaqësues tipik i frymës së pop-artit me primesa të ekspresionizmit abstrakt. (Hivzi Muharremi)

XHAFERI Arbën (1948-2012). Politikan, publicist. Lindi në Tetovë, shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Tetovë, ndërsa studioi për filozofi në Universitetin e Beogradit. Deri në vitin 1990 punoi në Televizionin e Prishtinës (TVP) si redaktor përgjegjës për programin kulturor. Pas mbylljes së TVP-së nga Serbia, punoi si kolumnist në të përjavshmen “Koha” në Prishtinë dhe shkruante për revistën “Forum”, që drejtohej nga Adem Demaçi. Në vitin 1993 u kthye në Tetovë, duke marrë drejtimin



ARBËN XHAFERI

Partisë për Prosperitetit Demokratik, e më vonë, pas përçarjes së saj, themeloi Partinë për Prosperitet Demokratik të Shqiptarëve (PPDSH), e cila iu bashkua Partisë Demokratike Popullore dhe mori emrin Partia Demokratike Shqiptare (PDSH). Për 12 vjet ishte kryetar i PDSH-së, deri në vitin 2007. Ishte deputet në Parlamentin e Maqedonisë nga viti 1994, njëri nga nënshkruesit e aktit të themelimit të Universitetit të Tetovës në vitin 1994 dhe njëri nga inicuesit e themelimit të Universitetit të Europës Juglindore (2001). Duke qenë pjesë e Qeverisë së Maqedonisë, me kryeministrin Lubço Georgievski menaxhoi fluksin e madh të refugjatëve shqiptarë nga Kosova në Maqedoni në vitin 1999. Gjatë konfliktit të armatosur në Maqedoni në vitin 2001, ishte nënshkrues i “Marrëveshjes së Prizrenit” (së bashku me kryetarin e PPD-së Imer Imerin dhe përfaqësuesin politik të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare, Ali Ahmetin) që unifikoi faktorin politik dhe ushtarak të shqiptarëve të Maqedonisë. Më pas u bë njëri nga nënshkruesit e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit (13 gusht 2001), e cila i dha fund konfliktit të armatosur në Maqedoni. Në shtypin shqiptar botoi shkrime të shumta për çështje të ndryshme politike, për zhvillimet në Maqedoni dhe në botën shqiptare në përgjithësi. (Arsim Sinani)

XHAFERI Mehmet (1933-2016). Ekonomist, profesor universiteti. Lindi në fshatin Dobërlukë, komuna e Vushtrrisë. Shkollën fillore e kreu në fshatin Smrekonicë të Vushtrrisë, shkollën e mesme në Prishtinë, Fakultetin Ekonomik në Zagreb, kurse studimet pasuniversitare në Beograd. Prej vitit 1967-1969 punoi në Entin Krahinor për Urbanizëm, kurse prej vitit 1969 u inkuadrua në procesin mësimor në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës, duke marrë të gjitha thirrjet akademike prej asistentit deri te profesor i rregullt për lëndën planifikimi i zhvillimit ekonomik. Në vitin 1978, në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Zagrebit mbrojti doktoratën me temë “Funksioni i veprimtarive terciare të Kosovës si territor i pazhvilluar i Jugosllavisë”. Krahas punës pedagogjike në fakultet, është autor i

disa punimeve shkencore mbi veprimtarinë ekonomike terciare në Kosovë, pastaj rreth planifikimit në ndërmarrje, mbi zhvillimin e veprimtarive terciare në literaturën e vendit dhe në botë etj. Është autor i një sërë punimeve profesionale dhe përkthyes i disa teksteve universitare. (Sinan Ademaj)

XHAFERI Musa (1959-). Veprimtar politik. Lindi në fshatin Zajaz të Kërçovës. Mbaroi shkollimin fillor në vendlindje, kurse të mesmen në Kërçovë. Kreu studimet në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës (1984). Gjatë periudhës së emigrimit në Zvicër, mbaroi studimet pasuniversitare dhe u specializua për arsimimin e të rriturve. Gjatë viteve 1996-2001 ushtroi profesionin e pedagogut-andragogut në Lucern (Luzern) të Zvicrës. Ishte i përfshirë edhe në aktivitetet politik kombëtar. Së bashku me aktivistë të tjerë themeloi Fondin “Liria Kombëtare” dhe u emërua drejtor i tij. Në vitin 2001 ishte njëri ndër themeluesit e Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare (UÇK) dhe më pas edhe anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së në Maqedoni. Në vitin 2002 ishte njëri ndër themeluesit e partisë Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI) dhe më pas u zgjodh deputet i saj në Kuvendin e Maqedonisë. (Fehari Ramadani)

XHAFERI Rudina (1978-). Dizajnere. Lindi në Prishtinë, ku kreu shkollimin fillor e të mesëm, ndërsa studimet për dizajn grafik në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. Punon në Radiotelevizionin e Kosovës dhe udhëheq sektorin e skenografisë nga viti 2003. Në vitin 1997 hapi ekspozitën e parë personale në Galerinë “Dodona” në Prishtinë. Pas kësaj hapi dhe disa ekspozita të tjera personale dhe mori pjesë në një sërë ekspozitash kolektive, brenda dhe jashtë vendit. Punoi në medime të ndryshme, si: pikturimi mbi thonj, fotografi, video, performancë, skenografi televizive, teatër dhe kostumografi. Së fundi punon në dizajnin e modës. (Zeni Balazhi)

XHAFERI Talat (1962-). Ushtarak, luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare, politikan. Lindi në fshatin Forinë të Gostivarit (Maqedoni). Kreu gjimnazin ushtarak në Beograd. Studioi në Akademinë Ushtarake në Beograd dhe në Sarajevë. Në vitet 1996-1998 u specializua për detyra të komandës dhe të shtabit në Akade-




TALAT XHAFERI

ku kreu detyra me rëndësi. Ishte komandant i Brigadës 111 “Beqir Limani” dhe pastaj i Brigadës 116 “Tahir Sinani”. Pas themelimit të BDI-së (2002), iu bashkua kësaj partie. Në vitin 2002 u zgjodh deputet në Kuvendin e Maqedonisë. Ushtrroi detyra dhe funksione me përgjegjësi në institucionet politike dhe shtetërore të Maqedonisë. (Fehari Ramadani)

XHAFERI Violeta (1947-). Artiste figurative, kostumografe. Lindi në Prishtinë. Kreu studimet për art figurativ në Shkollën e Artit Pedagogjike në Prishtinë më 1968. Më pas studioi për kostumografi në Akademinë e Arteve Aplikative në Beograd (1972). Në vitet ’70 dhe ’80 bëri kostumet për një sërë shfaqjesh në Teatrin Popullor Krahinor të Prishtinës, të zhanreve dhe të stileve të ndryshme. Po në këtë kohë punoi kostumet për filmat e “Kosovafilmit”: “Kur pranvera vonohet” dhe “Proka” dhe për projektet televizive “Migjeni” dhe “Trimi”. Në këtë periudhë u prezantua edhe në ekspozita të ndryshme të përbashkëta të artistëve aplikativë të Kosovës. Mori çmimet e para në Sallonin Pranveror në Prishtinë dhe në takimet e Teatrove të Serbisë, “Joakim Vujiq”. Në fillim të viteve ’90 e vazhdoi veprimtarinë në Norvegji. Në vitin 1998, me projektin “Arti i pajetë” hap ekspozitën e pavarur në “Galerinë 9” në Kristiansand dhe në Galerinë “Ryvarden” në Sveio të Norvegjisë. Në vitin 1999 gjithashtu mori pjesë në ekspozitën kolektive në Galerinë e Sorlandit po në këtë qytet, ku më pas hap ekspozitën e pavarur në Galerinë “Smia” dhe mori pjesë në ekspozitën vjetore të Sorlandit. Në vitet 2000-2002 hapi ekspozita të pavarura Adger, gjithashtu në Norvegji. Në vitet 2003-2004 hapi ekspozita të pavarura në Galerinë e Arteve të Kosovës dhe në Galerinë Kombëtare të Arteve në Tiranë. (Jeton Budima)

XHAFOLLI Gani (1942-2015). Shkrimtar, gazetar, botues. Lindi në Drenoc të Prishtinës.



GANI XHAFOLLI

e Prishtinës. Pas mbylljes së Televizionit nga pushteti serb, botoi revistat letrare për fëmijë “Zanore”, “Zogu i mëngjesit” dhe “Mollëkuqja”. Vitet e fundit udhëhoqi Shtëpinë Botuese “Asdreni”. Shkroi kryesisht për fëmijë: poezi dhe prozë (romane). Ishte fitues i çmimeve letrare “Vehbi Kika”, “Agim Ramadani”, “Ymer Elshani”, për poezi dhe prozë. Është ndër autorët më novatorë për fëmijë në Kosovë. Poezinë e shkruante kryesisht me varg të lirë, me shprehje koncize e të figurshme. Edhe në prozë i ikën rrëfimit tradicional. Botoi një numër përmbledhjesh me poezi dhe disa romane: “Te porta e edhave” (1979), “Kroi thërret dallëndyshet” (1987), “Shtëpia me kulm teposhtë” (1988), “Lejleku i syrit” (1992), “Po” (2003), “Të dua” (2004), “Princesha që fluturon” (2006) etj. (Arif Demolli)

XHAGOLLI Agron (1949-). Mbledhës dhe studiues i folklorit. Kreu studimet për gjuhë shqipe dhe letërsi në Fakultetin Histori-Filologji të Universitetit të Tiranës (1971). Nga viti 1975 punoi në Institutin e Folklorit dhe më pas në Institutin e Kulturës Popullore (IKP), ndërsa që nga viti 2008 punon në Institutin e Antropologjisë Kulturore dhe të Studimeve të Artit, si ligjërues dhe studiues i folklorit. Kreu ekspedita folklorike në të gjitha rrethet e Shqipërisë, në Kosovë, në Maqedoni dhe tek arbëreshet e Italisë. Ka realizuar si autor dhe bashkautor botimin e nëntë veprave folklorike: “Fjalë të urta të popullit shqiptar” (1983), “Proza popullore” (vëllimi VI, 1988), “Folklor kosovar I, Epika historike” (1985), pastaj “Këngë polifonike labe” (1986), “Këngë popullore të rrethit të Përmetit” (2007) etj. Është autor edhe i monografive studimore “Klasifikimi i prozës popullore shqiptare” (2001) dhe “Etnologjia dhe folklori shqiptar” (2007). Ka marrë pjesë me kumtesa në shumë tubime shkencore dhe ka botuar artikuj shkencorë në revistat shkencore brenda dhe jashtë vendit. Gjithashtu

mori pjesë në organizimin dhe zhvillimin e festivaleve folklorike kombëtare dhe ishte edhe drejtor i IKP-së në Tiranë (1994-2009). (Vlorë Fetaj-Berisha)

XHAKA Granit (1992-). Futbollist. Lindi në Basel të Zvicrës. Së bashku me vëllanë e tij, Taulantin nisën karrierën te skuadra e të rinjve “Concordia Basel” në vitin 2000. Vetëm dy vjet më vonë, që të dy iu bashkuan të rinjve të “Baselit” dhe deri në vitin 2010 ishin anëtarë të ekipeve të reja. Në vitin 2010 u bë pjesë e ekipit të parë të “Baselit” me të cilin luajti për dy edicione. Gjatë kësaj kohe fitoi dy herë titullin e kampionit të Zvicrës dhe një herë kupën. U shpall futbollisti më i mirë i kampionatit zviceran (2012). Në verën e vitit 2012 nga Baseli kaloi në Bundesligë, te skuadra gjermane “Borussia Monchengladbach”. Te Zvicra debutoi në ndeshjen mënjaneuse për “Euro 2012” kundër Anglisë në vitin 2011. Ishte pjesë e Zvicrës në Kampionatin Botëror “Brazil 2014” dhe shënoi gol në ndeshjen e fazës së grupeve kundër Francës. Nga edicioni 2016/17 u bë pjesë e skuadrës së njohur angleze “Arsenal”. (Arsim Maxhera)

XHAKA Rexhep (1945-). Futbollist, trajner. Lindi në Mitrovicë. Si 13-vjeçar filloi hapat e parë të futbollit. Në vitin 1958 u regjistrua te skuadra e “Trepçës”. Pas paraqitjeve të mira, u ftua për të qenë pjesë e skuadrës së pionierëve të Kosovës. Pjesë e “Trepçës” ishte deri në vitin 1962, pastaj kaloi te skuadra e seniorëve të “Remontit” të Mitrovicës. Në vitin 1967 ka firmosur kontratë profesionale me skuadrën e “Trepçës”, për të cilën luajti deri në përfundim të karrierës. Në vitin 1977 e ndërpret futbollin aktiv, pasi “Trepça” u inkuadrua në ligën e parë federative të ish-Jugosllavisë. Më pas vazhdoi punën si trajner, fillimisht si ndihmës i skuadrës së parë dhe pastaj trajner i kategorive të reja te kjo skuadër. U angazhua në futbollin mitrovicas edhe pas luftës së vitit 1999 te skuadra “Trepça ‘89”. Bën pjesë në gjeneratën e artë të skuadrës së “Trepçës”. (Arsim Maxhera)

XHAKLI Haki (1952-). Pikturor. Lindi në Ferizaj. Mori arsimin bazë në vendlindje. Kreu Fakultetin e Arteve në Prishtinë, drejtimin e pikturës më 1978. Po aty, më 2010 kreu studimet pasuniversitare, ndërsa tezën e disertacionit të doktoratës e kreu në shkencat filologjike në

Universitetin e Shkupit. Në vitet 1977-1995 punoi në gjimnazin e Ferizajt, ndërsa aktualisht është mesimdhënës në Fakultetin e Edukimit të Universitetit të Prishtinës, ku ligjëron artet figurative me metodologji. Hapi disa espozita personale: në Gjermani (1999), në Galerinë e Ministrisë së Kulturës në Prishtinë (2003, 2006), në Muzeun Historik Kombëtar në Tiranë (2011), në galerinë e qytetit në Ferizaj (2012) etj. Nga viti 1978 mori pjesë në disa ekspozita kolektive brenda dhe jashtë vendit. Është fitues i disa çmimeve për pikturë dhe aktivitete figurative. (Rexhep Ferri)

XHAMIA ATIK, GJILAN (Shek. XVII).

Në popull njihet edhe me emrin Xhamia e Medresesë. Është xhamia e parë në qytetin e Gjilanit, e ndërtuar më 1606 apo 1609. Xhamia ka sallën e lutjeve me kupolën qendrore, e cila është karakteristike në Kosovë, sepse është e mbuluar me tjegulla. Xhamia ka minaren, ndërsa portiku, dikur funksional, është hequr në vitin 1993, kur xhamisë i është shtuar një aneks. Xhamia është ndërtuar me material të ndryshëm: gurë, tulla, hatulla vertikale dhe horizontale, llaç gëlqereje dhe thupra të shtypura (shtupë). Hyrja për në sallën e lutjeve kalon nëpërmjet aneksit nga ana perëndimore. Mihrabi është trajtuar me piktura murale me motive florale, ku dominon ngjyra e kafes. Mimeri është i vendosur në të djathtë të mihrabit, është punuar me drugdhendje me motive të ndryshme gjeometrike. Qyrsi është i vendosur në kënd të majtë të mihrabit dhe nuk është funksional. Minarja gjendet në murin jugor, ka bazë dhe trung rrethor. Në pjesën e sipërme gjendet sherefja e dekoruar me motive gjeometrike. Enterieri i Xhamisë Atik është i pasur me piktura murale. Kupola e xhamisë është e ndërtuar me tetë hapësira, në të cilat janë të hapura tetë dritare katrore nga brenda, ndërsa me gjysmëhark nga jashtë. Dekorimet janë me motive bimore, që i takojnë stilit osman ose atij persian. (Ramadan Shkodra)

XHAMIA E BAJRAKUT NË PRIZREN. U ndërtua në vitin 1537 nga Gazi Mehmet pasha, prandaj njihet edhe si xhamia e Gazi Mehmet Pashës. Është objekti qendror i kompleksit të vakëfit të tij, i cili përbëhet edhe nga medreseja, tyrbja dhe hamami, i ndërtuar pak vite para xhamisë, medresesë me bibliotekë dhe tyrbes. Tyrbja u ngrit si vend ku do të varrosej vetë



XHAMIA E BAJRAKUT NË PRIZREN

legatori, por ai u vra në luftë në sanxhakun e Budimit (Hungari) dhe atje u varros. Objektet e tjera të këtij kompleksi, imareti dhe karvansaraji, janë ngritur afër xhamisë, pas vdekjes së legatorit (1551), sipas testamentit dhe parave që iu kishte lënë pasardhësve të vet dhe kuratorit të legatës. Ato u ndërtuan në vitin 1573. Po në këtë vit imami i kësaj xhamie, sheh Aliu përpiloi mbishkrimin me kronogram, që edhe sot qëndron mbi portalin e saj. Kompleksi si tërësi me 34 dyqane u legalizua në vitin 1580 me aktin zyrtar përkatës. Këtij kompleksi më vonë iu bashkua edhe ndërtesa e ngritur për bibliotekë publike dhe e legalizuar nga Said Pashë Rrotlla në vitin 1805. Xhamia është e stilit klasik osman, me sallë katrore të mbuluar me kupolë gjysmësferike me 13. 20 m. Së bashku me hajatin kanë sipërfaqen prej 771 m², kurse së bashku me avllinë kanë 1, 907 m². Është xhami monumentale, ndër më të vjetrat dhe më të mëdhatë në Kosovë. Në këtë xhami është mbajtur Kuvendi i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (10 qershor 1878). (Nehat Krasniqi)

XHAMIA E BAJRAKUT, PEJË. Është objekt njëhapësinor, i mbuluar me një kupolë qendrore dhe tri kupola të vogla mbi hajatin. U ndërtua nga Mahmud Pashë Dukagjini (1403-1474), i lindur në Pejë, i cili, si sanxhakbe i Dukagjinit, e shndërroi në xhami Kishën Katolike të Dukagjinasve dhe e pagëzoi me emrin e sulltan Mehmetit II Fatih. Xhamia u njoh në popull si Bajrakli Xhamia apo Çarshi Xhamia,

meqë ndodhet në qendër të Pejës. Mahmud Pashë Dukagjini pranë kësaj xhamie ndërtoi edhe shumë dyqane si vakëf. Xhamia, pos tjerash, veçohet edhe me dekorime pikturale të realizuara në seko-teknikë. Në kuadër të xhamisë janë edhe varrezat, ku varroseshin qytetarët e njohur të Pejës. (Gazmend Rizaj)

XHAMIA E ÇARSHISË, PRISHTINË (shek. XV). Gjendet në qendër të Prishtinës, përballë Muzeut të Kosovës (ish-ndërtesa e komandës së ushtrisë osmane) dhe matanë rrugës që



XHAMIA E ÇARSHISË NË PRISHTINË

kalon pranë Kuvendit të Kosovës, në anën tjetër. Xhamia filloi të ndërtohet më 1389, në kohën e sulltan Bajazitit, ndërsa ndërtimi i saj përfundoi në dekadën e shtatë të shekullit XV, në periudhën e sulltan Mehmetit II. U ndërtua me gurë dhe me llaç. Ka formë kubike dhe është e mbuluar me kupolë sferike. Përveç se është objekti më i vjetër në Prishtinë, ajo është edhe xhamia e parë e ndërtuar në Kosovë. Brendia e xhamisë (salla për namaz) ka vëllim unik dhe është e mbuluar me kube, e cila ndriçohet nga 33 dritare të vendosura në muret anësore të xhamisë dhe në bazën e kupolës qendrore. Në sallën e namazit hyhet nëpërmjet portës që është në anën veriore, apo në ballin hyrës. Mihrabi është i punuar nga mermeri. Edhe minberi, i vendosur në anën e djathtë të mihrabit është i ndërtuar nga mermeri. Mahfli është i ngritur në katër shtylla dhe bie në sy që në hyrje të xhamisë. Pjesa më e veçantë e

kësaj xhamie është minarja, e cila është ndër të rrallat, e ndërtuar nga fillimi e deri në mbarim me gurë të latuar, përfshirë këtu edhe majën e saj. Meqë minarja është e ndërtuar tërësisht nga guri, edhe xhamia e ka marrë emrin Xhamia e Gurit. Xhamia në brendinë e saj është e dekoruar me piktura murale dhe ornamente që paraqesin vlera artistike. Dekorimet e pikturave janë realizuara në seko-teknikë. Përveç luleve të stilizuara, paraqiten edhe figura gjeometrike, motive arkitektonike, selvi etj. (Ramadan Shkodra)

XHAMIA E DEFTERDARIT, PEJË. Objekt i kultit islam nga shekulli XVI. Gjendet në pjesën perëndimore të varrezave të vjetra të Kakariqit, përkatësisht në kuadër të ish-kompleksit të vjetër të familjes së Mahmutbegollëve. Donator i xhamisë ishte defterdari nga familja Begolli. Objekti fetar është ndërtim njëhapësinor, i mbuluar me kube të verbër në enterier, kurse nga jashtë ka çati katërujësh, të mbuluar me qeramidhe tradicionale. Hapësira e xhamisë përfshin sallën e lutjeve, hajatin dhe minaren. Hajati i xhamisë sot është i mbyllur dhe nuk është në ndërtim në gjendjen e parë. Salla e lutjeve ndriçohet nga dy rende dritaresh të mbuluara me hark. Dritaret janë të ndërtuara me gurë të përpunuar, për dallim nga struktura tjetër e murimit. Me gurë të përpunuar janë edhe qoshet e mureve dhe kurora e çatisë. Në enterierin e xhamisë veçohen mihrabi, minberi dhe mahfli. Mihrabi si kamare është i realizuar në pjesën qendrore të murit dhe tregon drejtimin e Qabesë. Minberi është nga druri dhe përdoret gjatë ceremonive të mëdha. Në kuadër të xhamisë janë edhe varrezat e qytetarëve të njohur, ku gjendet edhe tyrbja e hapur e defterdarit me gruan e tij. Xhamia e Defterdarit nuk është ruajtur në gjendjen origjinale, sepse u dogj në luftën e fundit nga forcat serbe. Xhamia është restauruar, por jo edhe mjedisi përreth, kështu që nuk është në harmoni me ambientin që e rrethon. (Fejaz Drançolli)

XHAMIA E EMIN PASHË RROTULLËS, PRIZREN. Xhami e ndërtuar nga familja Rrotulla, e cila sundoi sanxhakun e Prizrenit gjatë shek. XVIII dhe gjysmës së parë të shek. XIX. Rrotullajt ndërtuan shumë objekte publike dhe të banimit në Prizren. Pinjollit i kësaj familjeje, Emin Pashë Rrotulla gjatë viteve 1841-1842 ishte mytesarif i sanxhakut të

Prizrenit dhe përballë hamamit të Gazi Mehmet Pashës ndërtoi kompleksin që përbëhej prej xhamisë (1831), medresesë me mësonjëtoresh, konviktit dhe objekteve të tjera përcjellëse. Xhamia është e ngjashme me atë të Sofi Sinan Pashës, por është me përmasa më të vogla. Planimetria e objektit është në formë katrore, me një pjesë të shtuar te mihrabi. Baza e kupolës qendrore mbështetet në një hark tetëkëndësh, hajatat janë të mbuluara me tri kupola, pjesa e mihrabit me gjysmëkupolë, ndërkaq kupolat dhe çatia e minares janë të mbuluara me plumb. Në hapësirën e brendshme mihrabi, mimeri, mahvili janë të zbukuruar me piktura murale. Në oborrin e kompleksit gjendet edhe varri i Emin Pashës. Xhamia e ka ruajtur origjinalitetin e saj. Gjatë viteve 1988-1995 janë bërë disa intervenime të vogla restauruese, ndërkaq në vitin 2014 filloi dhe vazhdon të implementohet projekti konservues-restaurues i xhamisë. Nga Enti për Mbrojtjen e Përmendoreve Kulturore të komunës së Prizrenit xhamia është shpallur përmendore kulturore. (Parim Kosova)

XHAMIA E GYLFEM HATUNIT, PEJË (shek. XVI). Xhami e ndërtuar nga familja e Gylfem Hatunit në Pejë, që në përkthim nga persishtja do të thotë xhamia e princshës me gojë trëndafili. Gylfem Hatuni ishte e bija e Halil Beut (sanxhakbe i sanxhakut të Shkodrës e të Dukagjinit) dhe mbesë e Mehmet Dukagjinit (sanxhakbe i Smederevës, 1459). Gylfem Hatuni jetoi në gjysmën e dytë të shekullit XVI. Xhamia e saj ekzistonte edhe sot, me tyrben e njohur të Gjylfem Hatunit, siç quhet nga banorët vendorë. Në të vërtetë, kjo xhami u ndërtua në mëhallën e Kapeshnicës në Pejë, e cila nga banorët pejanë quhej edhe mëhalla e Gjylfem Hatunit. Në gjysmën e dytë të shekullit XVI, kur u themelua si mëhallë, i kishte gjithsej 15 shtëpi, ndërsa nga shekulli XVIII, kur mëhalla u zgjerua në drejtim të perëndimit, pjesa e re e mëhallës e mbajti emrin mëhalla e Kapeshnicës, kurse pjesa përfaqësojë Xhamisë së Gjylfem Hatunit vazhdoi ta mbante emrin mëhalla e Gjylfem Hatunit. Gjatë luftës së fundit në Kosovë (1999) varrezat e xhamisë dhe tyrbja e Gjylfem Hatunit pësuan dëmtime serioze. (Gazmend Rizaj)

XHAMIA E HADUMIT, GJAKOVË. Objekt fetar klasik monumental, i mbuluar me kube. Xhamia gjendet në zonën historike të Çarshisë



XHAMIA E HADUMIT NË GJAKOVË

së Vjetër në qytetin e Gjakovës. Donator ishte Hadum Sylejman efendia Hadum Aga. Xhamia u ndërtua rreth viteve 1594/95, është e mbuluar me kube dhe i takon formës së xhamive të stilit osman, me veçori të ndërtimit vendor. Xhamia ka bazën katërkëndëshe kënddrejt me minare të dalë nga muri në anën jugperëndimore. Përbëhet nga salla e lutjeve, hajati dhe minarja. Salla e lutjeve ka vëllim unik dhe formë katrore, mbulohet me kube të verbra që qëndrojnë mbi trompe. Unaza e kubesë nuk ka dritare. Në enterierin e ndërtimit shquhen mihrabi, mimeri dhe mahvili. Këto elemente konstruktive e funksionale, pos mahvilit, janë të vendosura në murin e kibles. Mihrabi veçohet me dekorimet e realizuara në teknikën e stalaktitit. Po ashtu edhe mahvili ka elemente me vlera arti dhe është prej druri. Pos që mbështetet në mure anësore, mbahet edhe në kolona. Hajati i xhamisë ka zgjidhje tradicionale dhe mbulohet me tri kube të madhësive të vogla. Tërë kubeja është e veshur me mbulesë plumbi, ndërsa minarja dominon me mjedisin e çarshisë. Xhamia veçohet me dekorime pikturale, arabeska dhe dekorime të plastikës së imtë. Edhe pse u dogj më 1999, pas restaurimit është kthyer në gjendje të mëparshme. (Fejaz Drançolli)

XHAMIA E HASAN AGËS (1580). Është objekt kulti i ndërtuar në fshatin Rogovë të Hasit. Ndërtuesi i xhamisë, Hasan Aga, ishte donator i disa objekteve publike në këtë zonë. Xhamia i ka disa karakteristika të veçanta,

veçmas në ndërtimin e kubesë njëhapësinore. Kubeja qëndron mbi qemerë gjysmëharkorë, me ndihmën e të cilëve është ngritur tamburi ose unaza e kubesë, e cila ka bazë tetëkëndëshe. Kubeja, njësoj si unaza nuk ka hapje, pra dritare dhe është identike me Xhaminë e Hadumit në Gjakovë. Objekti është njëhapësinor dhe ka minaren dhe hajatin. Minarja është e vendosur në pjesën jugperëndimore të objektit dhe është ngjitur me mure. Minarja është e veçuar me sherefën e saj. Hajati i xhamisë nuk është i kohës dhe nuk është i koordinuar me objektin e kultit. Për dallim nga objektet e tjera të kultit islam, kjo xhami është paksa më modeste në dekorimet piktorale dhe plastike dhe, si e tillë, paraqitet si e veçantë në ndërtimin e objekteve të tilla në Kosovë. Skema kompozicionale dhe elementet e tjera përmbajtësore dhe formale janë identike me ndërtimet e veprave të kultit islam. Gjatë luftës së fundit xhamia është bombarduar, por pas restaurimit është kthyer në gjendjen fillestare. (Fejz Drançolli)

XHAMIA E JAHJA PASHËS, SHKUP. Xhamia u ndërtua në fillim të shek. XVI. Ndërtuesi dhe financuesi i kësaj xhamie ishte Jahja Pasha. Fillimisht xhamia ka pasur kube mbi pjesën kryesore si dhe pesë kube me përmasa më të vogla dhe një minare të lartë. Me kalimin e kohës, ajo u dëmtua, ndërsa me rinovimet e herëpashershme pësoi ndryshime nga pamja origjinale. Aktualisht, Xhamia e Jahja Pashës në Shkup ka një kube piramidale. Në të dy anët e xhamisë hetohen rrënojat e objekteve të tjera përcjellëse që ka pasur më herët. Xhamia karakterizohet nga dekorime të shumta, veçmas në punimin e mihrabit, minberit, minares dhe të portalit, të punuar në mermer dhe në dru. Si motiv qendror dekorues në derën e hyrjes është përdorur ylli dhjetëkëndësh i gdhendur në ashtin e elefantit. (Hamdi Mehdiu)

XHAMIA E JASHAR PASHËS, PRISHTINË. Të dhënat burimore për kohën e saktë të ndërtimit të kësaj xhamie mungojnë. Tipologjia arkitektonike, dimensionet murale dhe të konstruksionit të kupolës të kësaj xhamie ngjajnë me xhamitë e shek. XV dhe XVI. Po ashtu ndërtuesit e parë të kësaj xhamie nuk dihen saktësisht, por supozohet të jenë të parët e familjes Gjinolli, me prejardhje nga Novobërda, ndërsa meremetimin e saj e kishte bërë njëri prej pasardhësve të kësaj familjeje,



XHAMIA E JASHAR PASHËS, PRISHTINË

Jashar Pashë Gjinolli në vitin 1835 gjë që e dëshmon mbishkrimi mbi portalin e saj. Edhe sipas vakëfnames së Jashar Pashës të vitit 1835, shihet se në këtë vit ishte bërë restaurimi i kësaj xhamie, e cila ishte dëmtuar rëndë gjatë luftërave austro-osmane të viteve 1689-1690, ose gjatë atyre të viteve 1737-1739. Renovimi i xhamisë nga Jashar Pashë Gjinolli u bë në kujtim të djalit të tij, Bahtijar Pashës, i cili gjatë viteve 1830/31 u vra në afërsi të Shkupit, në kohën kur pashallarët shqiptarë tentonin të qeverisnin në mënyrë të pavarur nga Sulltani, të udhëhequr nga Mustafa Pashë Bushatliu dhe nga Mahmut Pashë Rrotilla. (Iljaz Rexha)

XHAMIA E LARME NË TETOVË. U ndërtua në vitin 1495. Objekti përbëhet nga salla e lutjeve, hajati, minarja, tyrbja dhe çezma. Forma e sotme arkitektonike dhe dekorimi u krijuan në gjysmën e parë të shekullit XIX. Xhamia në brendi ka formë katrore, salla e lutjeve ka vëllim unik dhe është e mbuluar me kube. Dekorimet e enterierit dhe të mureve të eksterierit pasqyrojnë një sërë motivesh gjeometrike dhe motive të florës. Anët e jashtme, si sofa, kapitelët e shtyllave, pjesët e brendshme, ballkonet, mihrabi, kubeja dhe prehri i kubes janë të zbukuruar në seko teknikë. Në anët lindore, perëndimore dhe jugore të objektit në katër radhë ka pano, të cilat janë të dekoruara me një program shumëngjyrësh. Panotë e sipërme kanë dekore të kafazit, kurse pjesët e poshtme, përveç dritareve, janë të dekoruara me ngjyrë



XHAMIA E LARME NË TETOVË

të kuqe dhe të gjelbër. Në pjesën veriore të objektit mbizotëron një program më i ndërlikuar i zbukurimit. Në kapitëlët e shtyllave të jashtme ka dekorime me motive të vazove me lule dhe përreth me gjethe. Tyrbja, si pjesë përbërëse e kompleksi, është ndërtim karakteristik i monumentit mbivarror të periudhës osmane të shek. XVI. (Hamdi Mehdiu)

XHAMIA E LLAPIT, PRISHTINË (shek. XV). Gjendet buzë rrugës që çon në drejtim të lagjes së Prishtinës “Kodra e Trimave”, apo të magjistrale që çon në drejtim të Llapit. Xhamia Ramadanie, që njihet edhe si Xhamia e Llapit, është një ndër xhamitë më të vjetra të Prishtinës dhe në Kosovë. Xhamia nuk ka mbishkrim, por supozohet se është ndërtuar më 1470 nga Ramadan Çausi, atë kohë vezir, emrin e të cilit e mban objekti fetar. Te kjo xhami kupola paraqet një ndër karakteristikat e saj, ngase njihet si kupolë me perimetër më të madh krahasuar me sipërfaqen e xhamisë. Baza e kupolës fillon që nga themeli i xhamisë. Në katër qoshet e kupolës kryesore gjendeshin portikët. Është godinë njëhapësinore, ka vëllim unik dhe është e mbuluar me kube, e cila ndriçohet nga 11 dritare të vendosura në muret anësore. Në sallën e namazit hyhet nëpërmjet portës së drunjte dykrahëshe. Xhamia ka formë katrore, ndërsa baza e minares është e ndërtuar në 12 kënde. Gjatë luftës së fundit në Kosovë më 1999, xhamia u dogj tërësisht nga forcat paramilitare serbe, ndërsa u restaurua në vitin 2009. (Ramadan Shkodra)

XHAMIA E MADHE, PRISHTINË (shek. XV). Gjendet në rrugën “Nazim Gafurri” në Prishtinë. Oborri i saj është në formë trekëndëshi dhe kufizohet me tri rrugë. Është ndërtuar me



XHAMIA E MADHE NË PRISHTINË

urdhër të sulltan Mehmetit II, emrin e të cilit edhe e mban. Sipas mbishkrimit, xhamia është ndërtuar në vitin 865 sipas hixhrit, që i përgjigjet vitit 1461. Është godinë njëhapësinore me kubënë me dimensione prej 14 m, e ndërtuar me tulla nga brenda dhe me gurë të gdhendur nga jashtë. Anash kupolës kryesore gjenden kupolat me tri kënde. Xhamia ka sallën e lutjeve, hajatin dhe minaren. Në xhami hyhet nga porta, që është e mbuluar me arkitra, ndërsa xhamia ndriçohet nga 37 dritare të formateve të ndryshme, që janë të vendosura në katër nivele. Mihrabi i xhamisë është nga mermeri i zbukuruar dhe në harmoni me ornamentet e xhamisë. Edhe minberi është i ndërtuar nga mermeri, i stolisur me një kurorë, sipas traditës dhe stilit osman. Brendia e xhamisë është e dekoruar me ornamentikë bimore, në seko-teknikë. Këto realizime të pikturave murale dekorojnë sallën e lutjeve me kube si dhe hajatin e xhamisë. Hajati (portiku) i xhamisë ka një zgjidhje tradicionale të këtyre ambienteve. Ai mbulohet me tri kube të vogla. Minarja e xhamisë është shumëkëndëshe, e ndërtuar me një stil të veçantë, që shpreh tendencën e hollësisë maksimale, sidomos në pjesën e sipërme. Duke marrë parasysh dimensionet, konstruksionin, realizimin dhe elementet dekorative së bashku me kohën e ndërtimit, kjo xhami është njëri

ndër objektet më të rëndësishme të periudhës osmane në Kosovë. Xhamia ruan gjendjen fillestare, por është restauruar disa herë, së fundi më 2010. (Ramadan Shkodra)

XHAMIA E MERRE HYSEIN PASHËS, PEJË.

Xhami e ndërtuar në shekullin XVI nga Merre Hysein Pasha, sadriazem nga Peja. Xhamia u ndërtua mbi themelet e xhamisë pa minare, të cilën e ndërtoi xhaxhai i tij, Halil Beu (i vdekur më 1545). Është e njohur si Xhamia e Merre Hysein Pashës, por në popull më shumë përdorej emërtimi Kurshumli Xhamia, sepse kupola e saj ishte e mbuluar me plumb. Sot nuk ekziston kupola dhe objekti është i mbuluar me çati katërujësh. Gjatë luftës së fundit në Kosovë (1999), xhamia u dogj nga ushtria dhe paramilitarët serbë. U rindërtua me ndihmën e “Caritasit” të Italisë, me ç’rast dolën në pah themelet e ndërtimit të hershëm nga Halit Beu dhe të ndërtimit të mëvonshëm të Merre Hysein Pashës. Në kuadër të xhamisë janë edhe varrezat, në mesin e të cilave edhe varri i Halil Beut nga shekulli XVI. (Gazmend Rizaj)

XHAMIA E MUSTAFA PASHËS, SHKUP.

U ndërtua në gjysmën e dytë të shek. XV nga Mustafa Pasha, një figurë e shquar e shtetit osman në kohën e sundimit të sulltan Bajazitit II dhe



XHAMIA E MUSTAFA PASHËS NË SHKUP

sulltan Selimit I. Xhamia veçohet për punimet e shumta artistike në brendinë e saj. Kompleksi i saj përbëhet nga salla e lutjeve, hajati, minarja

dhe Tyrbja e Mustafa Pashës. Kupola e xhamisë ka diametrin 16 m. Para hyrjes së xhamisë, lart ngrihen 3 kupola. Portali i xhamisë paraqet një drejtkëndësh i punuar në mermer. Në brendinë e xhamisë, në pjesën e përparme, gjendet mihrabi po ashtu i tëri në mermer të bardhë. Ndër pjesët e veçanta të xhamisë është edhe minberi, i cili është i dekoruar nga mermeri i bardhë dhe është i vendosur në anën e djathtë. Konstruksioni i çardakut është i punuar nga druri. Në çdo element arkitektonik të xhamisë manifestohet arkitektura orientale. Bien në sy veçmas arabeskat (pandantifet) në katër këndet e xhamisë. Gjatë historisë xhamia pësoi dëmtime të mëdha nga faktorë të ndryshëm. (Hamdi Mehdiu)

XHAMITË MONUMENTALE. Ndërtime të periudhës osmane në disa qytete të Kosovës nga viti 1461 deri në vitin 1615. Xhamitë e para monumentale në Kosovë u ndërtuan aty ku ishin tregjet, në një trekëndësh që përfshinte tregun, xhaminë dhe çarshinë. Në kushtet e përhapjes së fesë islame filluan të depërtonin edhe elementet lindore të kulturës dhe të artit. Kjo vërehet më së miri në ndërtimin e xhamive monumentale të periudhës së hershme të sundimit osman, të kombinuara me elemente vendore. Objektet e kultit monumental i karakterizon skema kompozicionale identike, teknika e ndërtimit, struktura e murimit, elementet e enterierit, pikturat dhe plastika gurore dhe funksioni i saj. Disa nga këto ndërtime nuk janë unike në konstruktimin dhe ndërtimin e kubeve, të mahfilit dhe të minares. Çdo xhami ka bazë katërkëndëshe kënddrejt, sallën e lutjeve, hajatin, minaren, oborrin me varreza, shatërvanin, e në raste të rralla edhe tyrben e donatorit. Salla e lutjeve ka vëllim unik dhe mbulohej me kube. Kubeja është e konstruktuar në teknikë dhe sistem pandantiv, trompe apo qemer. Pos kubesë qendrore, xhamitë kanë edhe kube të vogla. Të tilla, si mbulesë, paraqiten në hajatin e xhamisë. Kubetë janë të mbuluara me plumb. Hajatet e xhamive monumentale veçohen edhe me kolonadat, të cilat i paraprijnë hyrjes në objekt. Hyrja është portali kryesor i xhamisë, është e mbuluar me hark nga guri i latuar. Nga brenda, dyert e drurit janë dykanatëshe të profilizuara. Mbi portalin hyrës kryesisht është mbishkrimi, që tregon donatorin e objektit. Mbishkrimi mund të jetë i gdhendur në gur, apo i shkruar

me kaliografi. Dritaret mund të jenë me dy apo tre rende, janë nga guri i latuar dhe të mbuluara me arkitra apo hark të thepisur. Ka raste kur paraqitet edhe rozeta. Struktura e murimit është e përzier me gurë e tulla të kuqërremta. Këto objekte karakterizohen edhe me kurora të çative që dalin nga muret perimetrale. Kurorat po ashtu janë nga guri i latuar.

Në sallën e lutjeve veçohet: mihrabi, i cili ka formë nikeje apo kamareje dhe është e vendosur në murin kryesor i orientuar nga Qabeja, Meka. Në këtë mur janë minberi si dhe qyrsi, dy elemente arkitektonike funksionale, që shfrytëzohen me rastin e festave të veçanta. Pos këtyre elementeve, në enterierin e xhamisë ekziston edhe mahfili, galeria e grave, e cila ngrihet mbi nivelin e portës kryesore të xhamisë. Mahfli, përveç që mbështetet në mure, qëndron edhe mbi kolona të drurit e, në raste të veçanta, edhe të gurit të përpunuar. Xhamitë monumentale dekorohen edhe me piktura murale apo arabeska të realizuara në seko-teknikë. Dekorimet shfaqen në muret e enterierit, rreth dritareve, pandantiveve, trompeve, kalotës, mihrabit, minberit, mahfilit si dhe në muret e hajatit dhe kalotat e kubeve. Pos dekorimeve piktorale, ka edhe plastikë të imët të realizuar në stuko-reliev (mihrab), minber, mahfil, minare, portal e shtylla. Xhamitë kanë edhe oborret, shatërvanët apo krojet për larje rituale. Disa nga këto oborre kanë varreza me mbishkrime dhe të dekoruara në plastikë gurore. Komplekset e xhamive monumentale kryesisht nuk e kanë ruajtje gjendjen origjinale, por gjatë kohës kanë përjetuar transformime dhe kanë humbur mjedisin fillestar. (Fejaz Drançolli)

XHARRA Arbana (1981-). Gazetare. Lindi në Gjakovë. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Gjakovë, kurse studimet i ndoqi në Prishtinë. Ka qenë pjesë e programeve të shumta për gazetari jashtë vendit, si në Universitetin e Mizurit në SHBA (2007) dhe më pas edhe në projekte të tjera për gazetari në Berlin, Vjenë e Strasburg etj. Punën e gazetares e filloi në “Koha ditore” (2001) dhe më pas (2009) në gazetën “Zëri”, fillimisht si redaktore dhe më vonë edhe kryeredaktore (2013). U shpërblye me shumë çmime për gazetari hulumtuese nga organizata kosovare dhe ndërkombëtare. Subjekte të shkrimeve të saj janë ekstremizmi fetar, korrupsioni dhe krimi i organizuar. U nderua me çmimin ndërkombëtar “Gra të guximshme”

(International Women of Courage Award-IWOC), që ndahet nga sekretari amerikan i shtetit (2015). (Gazmend Sylja)

XHARRA Jeta (1978-). Gazetare. Lindi në Prishtinë, ku mbaroi shkollën fillore dhe të mesme. Kreu studimet për dramaturgjë në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës,



JETA XHARRA

ndërsa në Londër kreu master po nga kjo fushë. Punën e gazetares e filloi me Radion BBC, si producente lokale dhe pastaj menaxhere e zyrës së BBC-së për Kosovë. Ishte edhe drejtore për Kosovë e Institutit për Raportim në Luftë dhe Paqe (IWPR). Në vitin 2005 themeloi Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) në Kosovë, në kuadër të të cilit ideoi dhe udhëhoqi emisionin “Jeta në Kosovë”, pastaj “Jeta në komunë”, program që i përcjell premtimet dhe realizimet e tyre nga kryetarët e komunave në mënyrë sistematike që nga viti 2007. Në vitin 2011 ishte bashkëthemeluese e gazetës “Jeta në Kosovë”. Ka botuar tekste autoriale në gazeta dhe medie të huaja dhe është bashkautore e shfaqjes “Koha e mbylljes”, e vendosur në skenë në Londër. Është drejtore e BIRN-it për Kosovë. Është fituese e një sërë çmimesh dhe mirënjohjesh për gazetari. (Ibrahim Berisha)

XHELADINI Shaban (1935-). Mësues veteran dhe veprimtar. Lindi në Tërnoc, gjimnazin e ulët e kreu në Preshevë, shkollën normale në Prishtinë, ku diplomoi më 1957. Emërohet mësues në Tërnoc, por për shkaqe politike autoritetet serbe e përjashtuan nga puna dhe e burgosën. Jashtë procesit mësimor mbeti deri në vitin 1966. Në vitin 1967 emërohet zëvendësdrejtore në shkollën e Tërnocit. Punoi shumë për themelimin e paraleleve të ndara të gjimnazit të Preshevës në Tërnoc dhe për arsimin në tërësi, sidomos për arsimimin e vajzave. (Gafur Hyseni)

XHEMAILI Mustafë (1954-). Shkrimtar, gazetar. Lindi në Shkup. Shkollën fillore e kreu në Komogllavë, ndërsa gjimnazin në Ferizaj, studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Nga viti 1976 e deri në fillim të vitit 1983 punoi si gazetar në Televizionin e Prishtinës,

ndërsa më pas në të përditshmen "Rilindja". Për shkak të veprimtarisë ilegale politike, në fillim të vitit 1984 emigroi në Zvicër. Krahas letërsisë është marrë edhe me publicistikë. Në periudhën 1984-1991 ka punuar si redaktor dhe kryeredaktor i gazetës "Zëri i Kosovës" në Zvicër, ndërsa më vonë edhe kryeredaktor i revistës "Ekskluzive" që dilte në Cyrih-Prishtinë-Tiranë. Ka punuar gjithashtu si zyrtar në Ministrinë e Kulturës dhe në Ministrinë e Diasporës të Kosovës. Ka botuar përmbledhjet poetike: "Netëve të verës" (1982), "Fusha e plagosur" (1993), "Sëmundjet e botës" (2001), "Bannon ëndrra në syrin tim" (2001), "Dorëshkrimi nga dheu" (2003). Në vitin 2004 i është botuar në gjuhën gjermane libri poetik "Arkitektura e stinëve". Punon në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Zvicër. (Munish Hyseni)

XHEMAILI Omer (1970-). Mjek, kirurg, kardiokirurg, profesor universiteti. Lindi në fshatin Tearcë të Tetovës, arsimimin bazë e mori në vendlindje, ndërsa studimet i filloi në Fakultetin e Mjekësisë në Sarajevë, të cilat i ndërpreu për shkak të luftës. Në vitin 1993 i rifilloi studimet e mjekësisë në Universitetin e Maincit. Pas diplomimit (1999) punoi në klinikën universitare të Maincit. Në periudhën 2000-2009 punoi në Klinikën Universitare të Frankfurtit, ku specializoi kardiokirurgjinë dhe kirurgjinë torakale (2006). U emërua docent për lëndën e kardiokirurgjisë në Universitetin e Frankfurtit dhe drejtor i Klinikës së Kardiokirurgjisë në Frankfurt (2006-2009). Temën e habilitimit e mbrojti në Universitetin e Frankfurtit (2009). Është kardiokirurgu i parë shqiptar që bëri transplantimin e zemrës. Publikoi shumë punime shkencore në revista të njohura profesionale. Për angazhimin profesional dhe akademik ka fituar disa çmime, ndër të cilat edhe çmimin "Hans Borst" i shoqatave gjermane, austriake dhe zvicerane për kardiokirurgji. Është anëtar i disa shoqatave dhe asociacioneve, përfshirë Shoqatën Europiane për Kardiokirurgji (EACTS). Jeton dhe punon në Gjermani dhe Zvicër. (Isuf Dedushaj)

XHEMAJ Bashmir (1983-). Gazetar. Lindi në Leskovec të Prizrenit. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Prizren, studimet për shkenca politike në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Kreu studimet pasuniversitare për marrëdhënie me publikun

dhe marketing në Greqi. Më 2006 nisi punën në Televizionin "Kohavision" (KTV), ku ndoqi zhvillimet dhe procesin politik para dhe gjatë shpalljes së Pavarësisë së Kosovës. Njëkohësisht bëri hulumtime që ndërlidheshin me korrupsionin. Nga viti 2008 deri më 2013 ka punuar edhe në Institutin e Prishtinës për Studime Politike, ku është përkujdesur për publikime që marrin në shqyrtim çështje të ndryshme të jetës politike dhe institucionale të Kosovës: për partitë politike, për Universitetin e Prishtinës, reformën zgjedhore, transicionin, demokratizimin etj. Ka fituar disa çmime për gazetari hulumtuese. (Ibrahim Berisha)

XHEMAJLI Blerim (1973-). Gazetar. Lindi në Mitrovicë. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Mitrovicë, ndërsa studimet për gazetari i ndoqi në Institutin për Gazetari dhe Komunikim KIJAC në Prishtinë. Nisi të punojë gazetar, duke raportuar nga Mitrovica, fillimisht për gazetën "Epoka e re" dhe më pas për gazetën "Koha ditore" (2000). Si gazetar në këtë gazetë raportoi për gjykimet për krime luftime në Tribunalin e Hagës në Holandë (2003 dhe 2006), ndërsa më pas ishte redaktor i rubrikave të ndryshme. Në vitin 2009 kaloi në televizionin "Klan Kosova", fillimisht si redaktor e më pas redaktor dhe kryeredaktor. Udhëheq redaksinë e lajmeve në "Klan Kosova". (Gazmend Sylja)

XHEMAJLI Emrush (1959-). Veprimtar, luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Lindi në fshatin Komogllavë të Ferizajt. Kreu shkollën e mesme në Ferizaj, ndërsa studimet për pikturë në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. Në vitin 1979 u arrestua dhe u dënua me 3 vjet e gjysmë heqje lirie. Pas lirimimit nga burgu për një kohë jetoi në ilegalitet, më pas emigroi në Zvicër. Gjatë viteve 1984-1987 punoi si gazetar dhe ilustrator në gazetën "Zëri i Kosovës". Në vitin 1991-1993 mori pjesë në aktivitetet e Lëvizjes Popullore të Kosovës (LPK) brenda vendit. Në vitin 1997 u zgjodh sekretar i përgjithshëm i LPK-së. Me fillimin e luftës (1998) u angazhua në Zonën Operative të Dukagjinit, në ndërlidhje, ndërsa në qershor 1998 u emërua shef i administratës dhe i personelit në Shtabin e Zonës Operative të Dukagjinit. Pas luftës u angazhua në Trupat Mbrojtëse të Kosovës, ndërsa në nëntor 1999, pasi u demobilizua, mori pjesë në organizimin

e luftës së Ushtrisë Çlirimtare për Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc (1999-2001) dhe të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare në Maqedoni. Ishte deputet i Kuvendit të Kosovës në legjislaturën e dytë dhe të tretë. (Ali Uka)

XHEMAJLI Muharrem (1973-). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Lindi në fshatin Abri e Epërme të komunës së Drenasit. Ishte aktiv në zhvillimet politike të viteve '90, në Lidhjen Demokratike të Kosovës, në Këshillin për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut dhe në Partinë Parlamentare të Kosovës. Nga viti 1995 u përfshi në radhët e UÇK-së. Më 11 shtator 1997 mori pjesë në aksionin kundër forcave serbe në Klinë, si dhe në sulmin të Fabrika e Municionit në Skënderaj, më 31 dhjetor 1997 etj. Më pas mori pjesë në betejën e grykës së Llapushnikut, në Rezallë, në Baicë, në Abri, në AçaREVë, në Hade, në mbrojtjen e grykës së Llapushnikut, të Dollcit etj. U plagos më 29 qershor 1998. Ishte zëvendëskomandant i policisë ushtarake si dhe anëtar i Trupës artistike ushtarake "Hamëz Jashari". Pas përfundimit të luftës punoi në Trupat e Mbrojtjes së Kosovës dhe në Shërbimin Policor të Kosovës. Nga UNMIK-u u arrestua dhe u mbajt në paraburgim në vitet 2002-2005, por u shpall i pafajshëm më 2008. (Sabit Sylja)

XHEMAJLI Valdet (1976-1998). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), dëshmor. Lindi në fshatin Abri të Epërme të komunës së Drenasit. Iu bashkua UÇK-së në shtator të vitit 1997 dhe bënte pjesë në grupin e Abrisë. Mori pjesë në betejën e grykës së Llapushnikut (maj 1998), në të cilën u plagos. Luftoi edhe në betejën e Gllarevës dhe në grykën e Dollcit, pastaj në luftimet në AçaREVë, në betejat e fshatrave Morinë, Rezallë e Likoc dhe në Baicë (shtator 1998). Ishte zëvendëskomandant batalioni për operacione në batalionin e parë të Brigadës 113. Ra në fushën e betejës në mes të fshatit Abri e Murg më 26 shtator 1998. (Haxhi Ademi)

XHENEZIN Monika (Monica Genesin) (1963-). Gjuhëtare italiane, ballkaniste. U diplomua në Universitetin e Padovës, ndërsa doktoroi në Universitetin e Kalabrisë, duke pasuar me specializime në Munihi të Gjermanisë. Punon hulumtuese për gjuhë dhe letërsi shqipe në

Universitetin e Salentos. Mori pjesë në konferenca të albanologjisë dhe të ballkanistikës. Është anëtare e Asociacionit Ndërkombëtar të Studimeve të Europës Juglindore (AIESEE). Botoi që nga viti 1990 artikuj që kanë të bëjnë me shqipen. Në mesin e punimeve të saj veçohen studimet për foljet apofonike të shqipes (1994), për sintagmën parafjalore ën+rrjedhore të "Meshari" i Buzukut, për laringalet e shqipes (1995), morfologjinë historike të foljes në gjuhën shqipe (1998), për disa shumësia të shqipes (2007). Ka studime të autorëve të vjetër të shqipes, në veçanti të Bukuzut e të Bogdanit. Kreu studime terreni në Theth. (Emilia Conforti)

XHEZAI RI Samidin (1963-). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Lindi në fshatin Bresanë të Opojës. Nga viti 1990 emigroi në Vjenë, ku ushtroi profesionin e teknikut mjekësor (1990-1998). Më 1998 u kthye në Shqipëri, për t'iu bashkëngjitur luftës për çlirimin e Kosovës. Nga fundi i shtatorit të vitit 1998 arriti të futet në Kosovë, së pari në zonën e Prizrenit, pastaj të Malishevës për t'iu bashkuar së fundi Brigadës 142 në Zonën Operative të Shalës dhe të Zonës Operative të Llapit. Më pas, në janar të vitit 1999 kaloi në Zonën Operative të Pashtrikut, ndërsa në mars bashkë me njësinë speciale të Brigadës 125 kaloi në zonën e Vërrinit. Gjatë periudhës së bombardimeve të NATO-s, bashkë me njësinë ku bënte pjesë veçoi në zonën e Prizrenit dhe të Opojës. Pas përfundimit të luftës dhe demobilizimit të UÇK-së vazhdoi jetën civile në Prizren. (Nuridin Ahmeti)

XHEZAI RI Selajdin (1960-). Gazetar. Lindi në Bozovcë të Tetovës. Hapat e parë në gazetari i bëri si nxënës i gjimnazit në mediet lokale. Punoi në Radio-Jugosllavi, më pas, në vitet '80 punoi si korrespondent nga Beogradi i Televizionit të Prishtinës dhe i gazetës "Rilindja" deri në mbylljen e tyre nga Serbia. Më pas ishte korrespondent nga Kosova i televizionit "Yutel". Në raportet e tij pasqyroi zhvillimet dhe ngjarjet e rëndësishme në Kosovë në fund të viteve '80 dhe në fillim të viteve '90. Më 1993 bëhet korrespondent nga Maqedonia i seksionit shqiptar të Radios BBC dhe më pas, deri në mbylljen e seksionit më 2011, ishte redaktor në redaksinë qendrore në Londër. Së fundi drejton televizionin e pavarur "Art" në Tetovë. (Nehat Islami)

XHIBO Xhelal (1936-2009). Specialist, infektolog, primarius. Lindi në Prizren, shkollën fillore dhe gjimnazin i mbaroi në vendlindje, u diplomua në Fakultetin e Mjekësisë në Shkup (1964). U punësua në Shtëpinë e Shëndetit në Prizren, pastaj kaloi në Qendrën Medicinale po në Prizren. Kreu specializimin në lëmin e infektologjisë në Universitetin e Shkupit. Dha kontribut të veçantë kur më 14 mars 1972, zbuloi rastin e parë të variola verës (lisë) dhe ndikoi në pengimin e përhapjes së kësaj sëmundjeje vdekjeprurëse. Për këtë meritë mori dekorata dhe mirënjohje të shumta nga institucionet e shtetit të ish-Jugosllavisë, por edhe nga Organizata Botërore e Shëndetësisë. Dy mandate ishte drejtor i Qendrës Mjekësore në Prizren. Mori pjesë në shumë seminare, simpoziume e kongrese dhe botoi shumë punime profesionale në revista të ndryshme. (Sali Ahmeti)

XHIHA Gonxhe (1965-). Kërcyese nga lartësitë në ujë. Lindi në Gjakovë. Në moshën 13-vjeçare u bë femra e parë në Kosovë që kërcëu nga Ura e Fshejtë mbi lumin Drini i Bardhë nga 18 metra lartësi. Në moshën 17-vjeçare synoi të kërcente nga ura e vjetër e Mostarit (Bosnjë e Hercegovinë), në lartësi prej 30 m, por nuk u lejua nga organizatorët për shkak të moshës së re. Pas një viti, ajo e realizoi synimin e saj, pasi organizatorët morën pëlqimin e prindërve dhe të Lidhjes së Notit të Kosovës. (Moral Pozhegu)

XHOGOVIQ Alia (Alija Džogović) (1929-2014). Poet boshnjak nga Kosova, studiues. Lindi në Zaton. Kreu gjimnazin në Pejë, ndërsa letërsinë jugosllave dhe gjuhën serbokroate i studioi në Fakultetin Filozofik në Beograd (1955). Punoi si mësimdhënës në shkolla të mesme dhe u mor me punë letrare dhe shken-core. Ishte pjesëmarrës në ngjarje të shumta letrare dhe në shumë kongrese jugosllave të folkloristëve, onomastikëve, leksikologëve, dialektologëve dhe etnologëve. Ishte bashkëpunëtor i Akademisë Serbe të Shkencave dhe të Arteve dhe anëtar i Akademisë Boshnjake të Shkencave dhe të Arteve. Botoi libra me poezi: “Lule dhe plagë” (1976), “Materixha” (1994), “Sarajevë, Guernika” (1995), “Stolitë e Aragonitit” (1995), “Origjina e këngës” (2005), Prej vitit 1957 e deri në vdekjen e tij jetoi në Pejë. (Ismet Marković)

XHUDOJA. Në Kosovë ka zënë fill në vitin 1968, kur u themelua klubi i parë me emrin “Universiteti”. Nismëtarë të parë të këtij sporti kanë qenë Alajdin Alishani, Hajrullah Tërnavë, Selatin Xhemshiti, Ismail Sokoli etj. Më pas u themeluan klubet gjithandej Kosovës, si në Vushtrri, Pejë, Ferizaj, Gjilan e Pejë, ndërkohë liga e Kosovës në xhudo u organizua në vitin 1974. Klubi më i mirë ishte “13 Maji” i Vushtrrisë, kampion i shumëfishtë i Kosovës. Pas luftës, suksesin më të madh e arriti Majlinda Kelmendin, e cila në Kampionatin Botëror të Francës (2009) fitoi medaljen e artë. Në Lojërat Olimpikë Verore “Rio 2016” në Brazil, M. Kelmedi u stolis me medaljen e artë në kategorinë deri në 52 kilogram, ndërsa po këtë vit Federata Ndërkombëtare e Xhudos e shpalli garisten më të mirë në botë në kategorinë e saj. Federata e Xhudos e Kosovës është anëtare me të drejta të plota në Federatën Ndërkombëtare të Xhudos që nga prilli i vitit 2012. Sukseset e xhudos lidhen kryekrejt me dy emra të shquar: Majlinda Kelemendin, kampione botërore dhe europiane dhe trajnerin e saj Driton Kuka. (Xhavit Kajtazi)

XHUVANI Aleksandër (1880-1961). Gjuhëtar, pedagog, veprimtar i arsimit, Mësues i Popullit. Lindi në Elbasan, ku kreu edhe shkollën fillore në gjuhën greke. Arsimin e mesëm e filloi në gjimnazin e Manastirit dhe e përfundoi në Kolegjin e Çotilit në Maqedoni (Greqi e sotme). Studioi në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Athinës (1902-1906). Punën arsimore e filloi më 1906 në Kolegjin e Shën Mitër



ALEKSANDËR
XHUVANI

Koronës (Kalabri). Në vitin 1909 emërohet mësimdhënës në Shkollën Normale të Elbasanit, ku punoi përreth tri dekada. Mori pjesë në formimin dhe në punën e Komisionit Letrar Shqipe në Shkodër (1916-1917), ishte kryetar i “Qarkut Letrar të Elbasanit” (1918), kryetar i Këshillit të Epërm Arsimor (1920), organizator dhe pjesëmarrës aktiv në kongreset e para pedagogjike kombëtare (1920, 1922, 1924), drejtor i gjimnazit të Shkodrës (1940), profesor në Institutin e Lartë Pedagogjik të Tiranës (1946) etj. Kontribuoi për ngritjen dhe zhvillimin e sistemit të arsimit kombëtar në baza

shkencore-profesionale, duke përfshirë standardet pedagogjike, legjislaacionin shkollor, tekstet shkollore, përgatitjen e kuadrit arsimor, terminologjinë pedagogjike-shkollore, organizimin e mësimi, dokumentacionin pedagogjik-shkollor etj. A. Xhuvani është themelues i pedagogjisë shqiptare. Dha kontribut të çmuar edhe në çështjen e alfabetit, të drejtshkrimit dhe të leksikologjisë, leksikografisë, frazeologjisë, fjalëformimit, morfologjisë, sintaksës, stilistikës, gjuhës letrare, etimologjisë etj. Për çështje gjuhësore shkroi një varg artikujsh dhe studimesh (“Studime gjuhësore”, “Për pastërtinë e gjuhës shqipe”). Drejtoi punën për kodifikimin e drejtshkrimit dhe për hartimin e udhëzuesve drejtshkrimorë të viteve 1948, 1951, 1953 dhe 1956. A. Xhuvani u shqua edhe në pedagogji dhe në psikologji, sidomos në pedagogjinë e përgjithshme, në historinë e pedagogjisë botërore dhe të asaj kombëtare, në fushën e didaktikës dhe të pedagogjisë shkollore dhe parashkollore, në arsimin e të rriturve, pedagogjinë familjare, pedagogjinë

speciale, metodikë, në psikologjinë e përgjithshme, pedagogjike etj. Shkroi disa vepra nga kjo fushë: “Didaktikë e Edukatë” (1926), “J.H.Pestalozzi. Jeta, veprat e pedagogjia e tij” (1927), “Psikologji e shtime në punë t’edukatës” (1933), “Didaktika” (1937) etj. Ishte autor i një varg tekstesh shkollore nga fusha e gjuhës për të gjitha nivelet e arsimit. Ishte i pari që përpunoi në shqip terminologjinë pedagogjike-shkollore.

Veprimtaria arsimore dhe shkencore e Xhuvanit pati ndikim të madh edhe në Kosovë dhe gjithandej viseve shqiptare, qoftë përmes mësuesve që ishin arsimuar në Normalen e Elbasanit, apo nëpërmjet teksteve shkollore. Autorët e gramatikave dhe të sintaksave të para të gjuhës shqipe, hartuar në Kosovë më 1950, ishin nxënës të Xhuvanit dhe janë hartuar sipas modelit të teksteve përkatëse të Xhuvanit. Edhe në fushën e gjuhësisë, vepra e Xhuvanit ushtroi ndikim në formimin e një brezi studiuesish dhe mësimeve të gjuhës në Kosovë dhe më gjerë. (Hajrullah Koliqi)


Y

YMERI Baki (1949-). Poet, publicist, përkthyes. Lindi në Shipkovicë të Tetovës, ku kreu shkollën fillore. Kreu shkollën e mesme në Tetovë, studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe i mbaroi në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës. Vuajti gjashtë vjet burg për veprimtari politike. Përktheu letërsinë shqipe në gjuhën rumune dhe anasjelltas. Është veprimtar i Bashkësisë Kulturore të Shqiptarëve të Rumanisë, njëri ndër themeluesit e Shoqatës së Miqësisë Rumuno-Shqiptare dhe redaktor i revistës “Shqiptari” në Bukuresht. Është autor i librave: “Kaltrina” (shqip-rumanisht, Bukuresht, 1994); “Dardania” (botim dygjuhësh, Bukuresht, 1999); “Zjarr i shenjtë” (2001); “Lumina Dardaniei/Drita e Dardanisë” (Bukuresht, 2004); “Rruga e Ferrit për në Parajsë (Bukuresht, 2005). Ka përkthyer nga rumanishtja në shqip autorët: Nikita Stënesku, Angjel Dumbrëveanu, Sllavko Almëzhan, Marin Sorescu, kurse në gjuhën rumune ka përkthyer disa libra të autorëve shqiptarë: Halil Haxhosaj, Sali Bashota, Ibrahim Kadriu etj. Është fitues i disa çmimeve dhe mirënjohjeve. (Salajdin Salihu)

YMERI Haki. (1937-). Dialektolog, leksikograf. Lindi në Kumanovë. Shkollimin fillor dhe të mesëm i kreu në vendlindje, ndërsa studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Shkup. Studimet pasuniversitare i vazhdoi në Prishtinë. Punoi si këshilltar pedagogjik në Entin e Përparimit të Arsimit dhe të Edukimit për shkollat shqipe të Shkupit. U morre me përkthime dhe redaktime të teksteve shkollore dhe me punë pedagogjike-metodike. Nga viti 1984 ligjëroi lëndët dialektologji dhe histori e gjuhës në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Shkupit. Më 1994 mbrojti doktoratën në Tiranë. Botoi një fjalor maqedonisht-shqip dhe shqip-maqedonisht

(1997) dhe monografinë “E folmja shqipe e Karshiakës” (1998). (Kadire Binaj)

YMERI Ismail (1956-2016). Regjisor filmi, producent. Lindi në katundin Baks, komuna e Skënderajt. Kreu aktrimin në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prishtinë, ndërsa në Zagreb



ISMAIL YMERI

mbaroi regjinë e filmit në Akademinë e Filmit, Teatrit e Televizionit. Punoi në Televizionin e Prishtinës, kryesisht në emisione dokumentare. Filmi i tij artistik i metrazhit të shkurtër “Duart e pastra”, prodhim i “Kosovafilmit”, një rrëfim interesant dhe provokues për një togë pushkatimi, që u shfaq për herë të parë në Festivalin e Filmit të Shkurtër dhe Dokumentar në Beograd, nxiti polemika të ashpra. Filmi u ftua në disa festivale ndërkombëtare. “Lepuri me pesë këmbë” ishte filmi i tij i parë artistik i metrazhit të gjatë, i cili po ashtu mori pjesë në disa festivale ndërkombëtare, duke paralajmëruar ardhjen e një brezi të ri të kineastëve në Kosovë dhe një frymë të re të qasjes ndaj luftës. Më pas filmi televiziv “Dhembja krenare”, që bënte portretin artistik të Migjenit u dha gjithashtu në disa festivale ndërkombëtare. Në vitin 2001 realizoi filmin “Kur shpirti ndërrom jetë”, që ishte një dramë për periudhën dramatike të jetës së shqiptarëve të Kosovës. Filmata dokumentarë: “Shpirti në mungesë”, “Druri dhe njeriu”, “Buzmi”, “Kurrë më”, “Marisa”, “Shpella e Gadimes”, “Elegji kullave”, “Kalorësi i drejtësisë”, “Gjurmë në kohë” etj., shënojnë një karrierë të frytshme. Gjithashtu bëri regjinë edhe të një sërë shfaqjesh teatrore. Vdiq në Stokholm, Suedi. (Gani Mehmetaj)

YMERI Rifat (1927-). Mjek, stomatolog, profesor universiteti. Lindi në Gjakovë, shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa gjimnazin në Prishtinë. U diplomua në Fakultetin e Stomatologjisë në Beograd (1960). Punoi në Shtëpinë e Shëndetit në Gjakovë dhe në Poliklinën e Dhëmbëve në Prishtinë. Specializoi në Beograd dhe më 1978 u zgjodh asistent në seksionin e stomatologjisë të Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë dhe më pas mori titujt docent dhe profesor inordinar. Ushtrroi detyrën e shefit të Klinikës dhe të katedrës të seksionit të Stomatologjisë. Magjistraturën dhe disertacionin e doktoratës i mbrojti në Fakultetin e Mjekësisë në Beograd. Në cilësinë e kryetarit të stomatologëve të Kosovës organizoi takime e manifestime profesionale, prej nga buroi edhe publikimi i parë i revistës profesionale-shkencore “Acta Stomatologica Kosova”. Është autor i një sërë punimesh profesionale dhe i teksteve mësimore “Sëmundjet e gojës” (1985) dhe “Parodontologjia dhe mjekësia orale” (2006). (Fatmir Dragidella)

YOUNG Antonia (1936-). Antropologe angleze. Në tridhjetë vitet e fundit u mor me hulumtime dhe studime të veçorive etnike dhe sociale të shqiptarëve në Shqipëri, në Kosovë



ANTONIA YOUNG

dhe në Mal të Zi. Si rezultat i këtij hulumtimi, në vitin 2000 botoi studimin më të kompletuar për virgjëreshat shqiptare të titulluar: “Gratë që bëhen burra: Virgjëreshat e përbetuara shqiptare” (Women who Become Men: Albanian Sworn Virgins, Berg Press US/UK 2000). Është gjithashtu edhe autore e bibliografisë së shkrimeve angleze për shqiptarët në Shqipëri dhe Kosovë (Albanian (including Kosova) annotated bibliography, Abc-Clio Press, Oxford & Santa Barbara, 1997)), si edhe bashkautore e studimit për gratë misionare në Ballkan: “Delet e zeza dhe thëllëzat gri: gratë udhëtare në Ballkan” (Black Lambs and Grey Falcons: women travellers in the Balkans, Bradford University Press, 1991). Është udhëheqëse e projektit për “Parkun e paqes në Ballkan”, që përfshin zonën kufitare që lidh Shqipërinë, Kosovën dhe Malin e Zi. Ishte ligjëruese e angazhuar në Universitetin e Bradfordit në Mbretërinë e Bashkuar dhe në Universitetin e Kolgejtit në SHBA. (Arbnora Dushi)

Z

ZABELINaser (1968-). Pedagog, mësimdhënës universiteti. Lindi në Rezallë, Skënderaj, ku kreu shkollën fillore dhe të mesme. Studioi pedagogjinë në Fakultetin Filozofik në Prishtinë, ku magjistroi dhe doktori. Punën e filloi si pedagog shkolle (1989-1995), ndërsa si asistent në departamentin e pedagogjisë të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës u pranua në vitin 1996, ku më pas u avancua me tituj të tjerë universitarë. Ka marrë pjesë në shumë projekte, konferenca vendore e ndërkombëtare, hulumtime dhe trajnime profesionale të mësimdhënësve. Fushë e interesimit të tij shkencor është teoria e mësimt, edukimi inkluziv, pedagogjia speciale etj. Është autor i disa punimeve shkencore-profesionale të botuara në vend dhe jashtë dhe i disa botimeve të veçanta: “Edukimi inkluziv-teori dhe praktikë aktuale” (2003), “Vështirësitë në të nxënë” (2004), “Strategjitë psikopedagogjike për reduktimin e sjelljes së papërshtatshme të nxënësve në klasë” (2008), “Indeksi për gjithpërfshirje-fakte dhe opinione” (2014) etj. Është edhe bashkautor i teksteve shkollore. (Xhafer Ismajli)

ZAHAQI. Fshat i tipit të dendur, rreth 7 km në lindje të qytetit të Pejës, në rrugën magjistrale Pejë-Prishtinë. Shtrihet në lartësi mbidetare 435 m, me sipërfaqe të territorit 257 ha, nga e cila pjesa dërrmuese është e mbuluar me ara dhe livadhe. Popullsia merret me bujqësi, me kultivimin e pemëve etj. Vendbanimi daton nga periudha antike. Përmendet në dokumentet mesjetare dhe në defterin osman të Sanxhakut të Shkodrës të vitit 1485. Me emrin Suhaq përmendet edhe në një hartë austriake të vitit 1689. Me këtë emër është regjistruar si vendbanim në një hartë osmane të fundit të shek. XIX dhe në

sallnamet e vilajetit të Kosovës të vitit 1893, 1896 dhe 1900. Banorët e fshatit janë kryesisht të ardhur nga Rugova. Megjithëse emigrimi që i vazhdueshëm, popullsia e fshatit ka shënuar rritje të vazhdueshme. Derisa në vitin 1921 Zahaqi kishte 253 banorë, në vitin 2011 në të jetojnë 1,120 banorë. Në aspektin funksional është bashkësi lokale, në të cilën gravitojnë vendbanimet Nakulla, Llabjani dhe Ramuni. Ka shkollën 9-vjeçare, stacionin shëndetësor, disa njësi tregtare dhe shërbyese etj. (Bajram Kafexholli)

ZAIMI Bardhyl (1970-). Shkrimtar, gazetar. Lindi në Sllatinë të Tetovës, ku e kreu shkollën fillore. Shkollën e mesme e kreu në Tetovë, kurse studimet për gjuhë dhe letërsi i mbaroi në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Tetovës, ku më pas kreu edhe studimet pasuniversitare. Ka punuar në disa medie të vendit dhe të huaja, të shkruara dhe elektronike. Disa vjet ishte redaktor në revistën kulturore “Brezi 9” dhe në redaksinë e kulturës në programin për gjuhën shqipe në Televizionin e Maqedonisë, kurse më pas redaktor në revistën “Nacional”. Është autor i librave eseistike: “Fuga e fjalës” (2004), “Violinat e vjeshtës” (2009) dhe “Flamurtari i shqiptarizms” (2012). (Salajdin Salihu)

ZAJAZI Tahir (1940-). Pedagog, profesor universiteti. Lindi në Zajaz të Kërçovës, ku kreu edhe shkollën fillore. Arsimin e vazhdoi në shkollën normale të Shkupit, si dhe në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Shkupit. Tezën e disertacionit e mbrojti në Universitetin e Tiranës (1992). Ishte mësues në Shkup, kryeshef i arsimit në Tetovë, arsimtar në gjimnazin e Tetovës, pedagog në Akademinë Pedagogjike në Shkup, këshilltar i pavarur i

arsimit në Maqedoni, njëri nga themeluesit dhe pedagog e dekan në Universitetin Shtetëror të Tetovës dhe pedagog në Universitetin e Europës Juglindore në Tetovë. Interesim shkencor shfaqti për shkencat pedagogjike, sidomos për didaktikën. Mori pjesë në mënyrë aktive në konferenca, simpoziume dhe tryeza shkencore. Është autor projektesh kërkimore-shkencore, tekstesh universitare dhe i disa veprave shkencore-profesionale, siç janë: “Efekti i mësimi të programuar laboratorik” (1994) “Pedagogjia e arsimit” (1997), “Metodologji të mësimdhënies dhe mësimnxënies” (2003) etj. (Fadbi Osmani)

ZAJMI Abdullah (1922-2001). Gjuhëtar. Lindi në Vushtrri. Shkollën normale e kreu në Shkodër. Më 1942 nis punën e mësuesit në Prishtinë, ndërsa më pas kreu detyra të ndryshme në arsim. U diplomua për gjuhë shqipe në Beograd. Ishte mësimdhës i Normales së Prishtinës, më pas punoi në Institutin Albanologjik të Prishtinës si bashkëpunëtor shkencor në sektorin e leksikografisë. Dha kontribut edhe për hartimin e teksteve shkollore në gjuhën shqipe dhe u mor me përkthime nga gjuha serbokroate në gjuhën shqipe. Si bashkautor botoi: “Fjaluer terminologjik serbokroatisht-shqip” (1961), “Fjalor serbokroatisht-shqip” (1974), “Fjalor serbokroatisht-shqip” (ribotim), “Fjalor shqip-serbokroatisht” (1981) dhe “Fjalor i fjalëve të huaja në gjuhën shqipe” (1987). Përpiloi edhe tekste shkollore. (Abrurrahim Maxhuni)

ZAJMI Agim (1942-). Agronom, profesor universitar, pemëtar. Lindi në Gjakovë, shkollën fillore e mbaroi në vendlindje dhe Prizren, shkollën e mesme bujqësore (pemëtari-vrështari) e mbaroi në Pejë (1963). Kreu studimet në Fakultetin e Bujqësisë të Universitetit të Sarajevës (1970), ndërsa studimet pasuniversitare në Fakultetin e Bujqësisë të Universitetit të Zagrebit (1978). Specializoi në Angers të



AGIM ZAJMI

Francës më 1985. Tezën e disertacionit e mbrojti në Fakultetin e Bujqësisë të Universitetit të Sarajevës (1986). Punësohet në Kombinatin bujqësor-industrial “Ereniku” në Gjakovë, më pastaj kalon me punë në Institutin Bioteknik

në Pejë (1973). Në vitin 1974 pranohet asistent në Fakultetin e Bujqësisë të Universitetit të Prishtinës për lëndën agrometeorologji me klimatologji dhe më pas për lëndën pemëtaria speciale, ku i arrin të gjithë titujt universitarë. Një kohë punoi këshilltar në Ministrinë e Bujqësisë, të Pylltarisë dhe të Zhvillimit Rural, pastaj konsulent për kultivimin e mjedrës në kuadër të USAID-it dhe NOA-s. Ka publikuar disa libra universitarë, punime shkencore dhe profesionale. Ka qenë prodekan dhe dekan i Fakultetit të Bujqësisë. Vazhdon të jetë aktiv në publikime shkencore dhe profesionale. Është bashkautor i disa librave: “Strategjia e zhvillimit ekonomik”, “Shartimi i pemëve”, “Kultivimi i dredhëzës” etj. (Bashkim Kabashi).

ZAJMI Bardhyl (1922-1998). Punëtor sportiv, mësimdhënës universitar. Lindi në Pejë, ndërsa kur ishte 2 vjeç emigroi me prindërit në Shqipëri. Në Tiranë mbaroi shkollimin fillor dhe të mesëm teknik. Në vitet 1945 shkon në Beograd dhe një vit më vonë regjistrohet në Institutin Shtetëror të Fizkulturës, si shkollim intensiv njëvjeçar. Në vitet '50 u caktua përgjegjës për jetësimin e sporteve në Kosovë (futbollin, basketbollin, volejbollin, hendbollin e madh, skijimin etj.), meqë deri atëherë nuk kishin asnjë formë të organizimit. Ishte mësimdhënës universitar dhe dekan i parë i Fakultetit të Kulturës Fizike. (Albatrit Matoshi)

ZAJMI Fatmir (1947-). Grafist. Lindi në Beograd. Kreu Shkollën e Lartë Pedagogjike, drejtimi i artit figurativ në Prishtinë. U diplomua në Akademinë e Arteve Figurative në Beograd më 1972, në drejtimin e grafikës, ku më pas i kreu studimet pasuniversitare (1974). Aktivitetin artistik e zhvilloi në Prishtinë, duke realizuar grafika në shtypin e rrafshët në sitoshtyp dhe duke trajtuar kompozicione bashkëkohore me frutat në hapësirë. Që nga vitit 1974 filloi të organizojë ekspozita personale: më 1974 në Sarajevë, në Pallatin e Kulturës “Kiselak”; më 1976 në Beograd në “Kolektivin grafik”; më 1982 Prishtinë në “Klubin e Artistëve”; më 1996 në Kragujevac, në Sallonin e Vogël të Arteve etj. Nga viti 1982 mori pjesë në një sërë ekspozitash të përbashkëta, përfshirë edhe ekspozitën grupore “Grafika e krijuesve kosovarë” në Zagreb, Dubrovnik, Beograd, Palermo, Damask, Munihi, Londër etj. Për punën e tij artistike mori mirënjohje

dhe çmime, ndër të cilët edhe çmimin për grafikë në Sallonin IX Pranveror të Kosovës më 1982. (Fatmir Krypa)

ZAJMI Gazmend (1936-1996). Jurist, politolog, profesor universiteti, akademik. Lindi në Krumë. Shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në Prizren, ndërsa Fakultetin Juridik dhe stu-



GAZMEND ZAJMI

dimet e magistraturës (drejtimi juridik-politik) i mbaroi në Universitetin e Beogradit. U doktorua në Fakultetin e Shkencave Politike të Universitetit të Beogradit më 1971. Pas diplomimit punoi si gjykatës dhe kryetar i Gjykatës së Rrethit të Prizrenit. Nga themelimi i Fakultetit Juridik në Prishtinë, më 1961, u zgjodh asistent për lëndën e drejta kushtetuese, ndërsa më vonë ligjëroi lëndën sistemi politik. Kreu detyra dhe funksione të ndryshme në institucionet dhe asociacionet e vendit: ishte kryetar i Shoqatës së Politikologëve të Kosovës, anëtar i Kryesisë së Lidhjes së Shoqatave të Shkencave Politike të Jugosllavisë, anëtar i Pleqësisë Federative Juridike, kryetar i Bashkësisë së Universiteteve të Jugosllavisë, anëtar i Komitetit të Konferencës Europiane të Rektorëve etj. Në vitin 1981, kur ndodhën demonstrata masive, G. Zajmi ishte rektor i Universitetit të Prishtinës, dha dorëheqje nga kjo detyrë dhe më vonë, si pasojë e diferencimit, u largua edhe nga procesi mësimor. Në fushën juridike dhe politikologjike me studimet e tij kontribuoi në sendërtimin e mendimit shkencor për statusin e Kosovës, si një dimension i çështjes shqiptare në Ballkan. Në shumë studime dhe në 4 monografite e tij, G. Zajmi e cilësonte ish-Jugosllavinë si “një krijesë shtetërore me komponentë të theksuar të padrejtësisë në dëm të popullit shqiptar në Ballkan”, ku rrafshi i parë i padrejtësisë ishte ndarja në dy gjysma të kundërvëna gjeopolitikisht, përmes kufijve të jashtëm të kësaj Federate; kurse rrafshi i dytë ishte mospranimi i statusit të barabartë politik institucional i gjysmës së kombit shqiptar në Ballkan, në kuadër të Federatës Jugosllave. Në punimet e tij përfundonte se zgjidhja e çështjes së Kosovës “është e mundur vetëm si realizim konsekuent i vetëvendosjes”. Ishte bashkautor i librit universitar të Universitetit të Beogradit: “Sistemi

shoqëror-politik i Jugosllavisë, ndërkaq nga monografite veçohet “Mbrojtja juridike-kushtetuese e gjuhëve të pakicave kombëtare”. Për rezultatet e tij në lëmin shkencor, pedagogjik dhe shoqëror-politik u dekorua me Urdhrin e Punës me Kurorë të Artë dhe me Urdhrin e Vëllazërim-Bashkimit me Kurorë të Artë. Pas vdekjes së tij, Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës e përmbloodhi dhe e botoi tërë opusin e tij krijues nga fusha juridike dhe politike. (Esat Stavileci).

ZAJMI Hajrullah (1938-1999). Pikturor. Lindi në Gjakovë, ku kreu shkollën fillore. Kreu Shkollën e Mesme të Artit në Pejë, ndërsa u diplomua për pikturë në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prishtinë (1963). Në fillim punoi në Gjakovë si pedagog i artit, pastaj u shpërngul në Murska Sobota (Slloveni), ku jetoi e krijoi vepra kryesisht me tematikë nga Kosova, duke kontribuar në afirmimin e artistëve të Kosovës në Slloveni, por edhe në Austri e Gjermani. Në këto shtete u paraqit edhe me ekspozita vetjake apo me Shoqatën e Artistëve Figurativë të Sllovenisë, anëtar i së cilës ishte. Nga viti 1964 ishte anëtar i Shoqatës së Artistëve Figurativë të Kosovës dhe pjesëmarrës i ekspozitave të rregullta të saj. Pas vdekjes (1999), në shenjë përkujtimi më 2002, në Galerinë e Ministrisë së Kulturës në Prishtinë dhe në Gjakovë u hap ekspozita e punimeve të tij. Vdiq në Murska Sobota. (Tahir Emra)

ZAJMI Hysni (1913-1943). Pjesëtar i lëvizjes antifashiste dhe komuniste. Lindi në Gjakovë. Shkollën fillore e mbaroi në vendlindje, ndërsa Medresenë e Madhe në Shkup. Në vitin 1935 kreu Shkollën Normale të Elbasanit. Punoi si mësues në fshatrat e rrethit të Kukësit. Mori pjesë në formimin e grupit komunist të normalistëve të Elbasanit. Ishte ndër organizatorët e demonstratave antifashiste në Tropojë dhe në Bicaj. Në prill 1941 u rikthye në Gjakovë dhe përfshihet në radhët e Lëvizjes Antifashiste. Punoi si mësues dhe u angazhua në hapjen e shkollave në gjuhën shqipe. Në nëntor 1941 organizoi demonstratat e para kundër okupatorit fashist në Gjakovë. Në vitin 1942 u burgos nga italianët dhe u dërgua në burgun e Pejës dhe më pas në burgun e Tiranës. Në maj të vitit 1943 u emërua përgjegjës i Komitetit Lokal të Partisë për Gjakovë, Rekë dhe Podrimë dhe

njëkohësisht anëtar i shtabit lokal të Partisë Komuniste për Gjakovë. U vra në rrethana të paqarta në Plavë të Malit të Zi në nëntor të vitit 1943, së bashku me disa anëtarë të shtabit të Batalionit “Bajram Curri”. (Sulltane Ukaj)

ZAJMI Ilire (1971-). Shkrimtare, gazetare. Lindi në Prizren, ku mbaroi shkollimin fillor e të mesëm, ndërsa studimet në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës (2004). Më



ILIRE ZAJMI

pas kreu studimet pas-universitare për gazetari. Nga viti 1999 punon në Radiotelevizionin e Kosovës (RTK). Gjatë kohës së luftës në Kosovë bashkëpunoi me mediet e huaja. Nga viti 2007 ishte korrespondente e agjencisë italiane ANSA.

Botoi disa libra me poezi: “Këmbanat e mëngjesit” (1991), “Baladë e bardhë” (2000), “Ëndërr e huaj” (2013), pastaj librin e poezive në gjuhën frënge “Ky është fundi” (C’est la fin, 2014) dhe në gjuhën angleze “Amnesia” (2011). Botoi romanet “Fashitja e ëndrrave rebele” (1996), “Era” (2014) dhe “Valsi i mesnatës” (2016). Është autore e librit studimor “Pamjet televizive dhe realiteti” (2011). Bashkë me gazetarin italian Filippo Landi botoi librin publicistik “Një tren për Blacë” (Un treno per Blace, 1999), i botuar edhe në shqip në vitin 2011. U prezantua në revista letrare dhe antologji ndërkombëtare. Poezitë e saj janë përkthyer në disa gjuhë dhe është fituese e çmimit “Ventennale” në Milano të Italisë (2011) dhe e çmimit të parë për poezi në “Mitingun e Poezisë” Gjakovë (2013). Është anëtare e asociacionit “Shkrimtarët e botës” (Poetas del Mondo). (Agron Gashi)

ZAJMI Lyra (1963-). Dizajnere, Lindi në Prishtinë. Studioi për dizajn grafik në Akademinë e Arteve në Prishtinë (1986). Është anëtare e shoqatave profesionale të artistëve në Kosovë dhe në Kroaci. Hapi disa ekspozita personale, ndër të cilat në Galerinë e Arteve në Prishtinë (2010), në Galerinë “Hamami” në Prizren (2011), pastaj në Muzeun Kombëtar të Kosovë në Prishtinë (2015), në Qendrën Kulturorë-Informative në Shkup, në Muzeun “Mimara” në Zagreb etj. Ka marrë pjesë në një sërë ekspozitash të përbashkëta dhe është

fituese e çmimeve profesionale, siç është çmimi “Marketing Distinction Award” nga Columbus Press për komunikim promotiv. Si dizajnere bashkëpunon me agjenci, botues, institucione dhe kompani të ndryshme, si me Agjencinë “Atlas” në Zagreb, “American Express”, “Prograf” etj. Krijon në fushat e komunikimeve vizuale, të fotografisë dhe dizajnit të interierit. (Hivzi Muharremi)

ZAJMI Musa (1923-1943). Veprimtar i lëvizjes antifashiste nacionalçlirimtare të Kosovës. Lindi në Gjakovë. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, më pas punoi si shegert (rrobaqepës) dhe vazhdoi shkollën profesionale të natës. Pas kapitullimit të Jugosllavisë mbajti kontakte me komunistët gjakovarë që vinin nga Shqipëria, si Fadil Hoxha, Emin Duraku, Hysni Zajmi etj., me përkrahjen e të cilëve u pranua në organizatën e rinisë komuniste. Mori pjesë në organizimin e demonstratës së 28 Nëntorit në Gjakovë më 1941. Në janar të vitit 1942 pranohet në radhët e Partisë Komuniste dhe zgjidhet udhëheqës i rinisë komuniste të Gjakovës, të Rekës dhe të Podrimës. Në këtë kohë bëhet edhe pjesëtar i njësitit gueril të qytetit. Në dhjetor të vitit 1942, në Malësi të Gjakovës i bashkohet aradhes partizane “Zenel Hajdini”, ndërsa me formimin e aradhes “Emin Duraku” (janar 1943), zgjidhet zëvendëskomisar politik. Më 26 prill 1943, aradhja partizane “Emin Duraku” në malet e Poneshit, afër Gjilanit u rrethua nga karabinierët dhe vullnetarët. Gjatë luftimeve u plagos, më pas vdiq nga plagët dhe u varros afër fshatit Ponesh të Gjilanit. (Blerim Haziri)

ZAJMI Tahir (1897-1971). Pjesëtar i lëvizjes kombëtare dhe antikomuniste. Lindi në Gjakovë. Familja e tij më 1918 u shpërngul në Shqipëri, së pari në Kukës dhe Krumë dhe më pas në Shkodër. Bashkëpunoi me Bajram Currin dhe me Komitetin “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës” dhe mori pjesë në luftimet kundër forcave të Esad pashë Toptanit, më 1920. Në vitin 1941 u kthye në Kosovë. Më 1943 u zgjodh sekretar i Lidhjes së Dytë të Prizrenit dhe si redaktor i gazetës “Lidhja e Prizrenit”. Nga fundi i vitit 1944 u largua nga vendi dhe mori rrugën e emigrimit. Qëndroi në Austri, Gjermani, Itali, Egjipt, Arabi, Siri dhe më vonë në Izmir të Turqisë. Veprimtarinë e Lidhjes së Dytë të Prizrenit e pasqyroi në veprën “Lidhja e

Dytë e Prizrenit dhe lufta heroike e popullit për mbrojtjen e Kosovës” (Bruksel, 1964). Vitet e fundit të jetës i kaloi në Belgjikë. Bashkëpunoi me shtypin e mërgatës, sidomos me “Shejzat” e Ernest Koliqit. Vdiq në Bruksel. (Muhamet Shatri)

ZAKONET FAMILJARE. Tërësi veprimesh me karakter praktik dhe magjike-apotropeike, që zbatohen në familje me rastin e lindjes, martesës dhe vdekjes.

Zakonet e lindjes shoqërohen me rite rreth lindjes dhe pas lindjes, me zakonet e kumbarisë së pagëzimit dhe të prerjes së flokëve, të përgimit etj. Bëhen një varg veprimesh magjike për gratë që nuk lindin ose lindin vetëm vajza. Kur lindja ishte e vështirë, praktikohesh pjesëmarrja simbolike e burrit në procesin e lindjes. Gruan shtatzënë e përshkojnë tri herë me tirqit e burrit të saj, si dhe me frerët e kalit. Në disa vende të tjera përdoret shoka ose opingat e burrit. Disa veprime kryhen për ta mbrojtur lehonën dhe foshnjën nga syri i keq dhe shpirtrat e ligj. Kështu, në djepin e foshnjës vendosin gërshërë me një hudhër në maje ose diku tjetër dhëmbin e ujkut dhe rruazat.

Martetat dhe dasmat shqiptare, në qytete e sidomos në fshatra, ruajnë shumë elemente të lashtësisë. Në tërësinë e martesës hyjnë: fjala e dhënë (fejesa), nata e kanagjeqit e vajzës, caktimi i ditës së dasmës, përgatitjet para dasmës dhe ceremoniali i dasmës. Disa doke të dasmës kryhen te porta e shtëpisë, në pragun e derës dhe në oxhakun e odës. Njëri prej tyre është doku i hedhjes së grurit, të elbit, të orizit ose të monedhave të argjendta mbi kokën e nuses, para se të shkelë pragun e shtëpisë së dhëndrit. Kur hyn nusja në shtëpinë e dhëndrit, ajo kapërcen pragun e portës me këmbë të djathtë dhe e lyen me mjaltë pragun e sipërm të saj, për të sjellë fat, mbarësi dhe lumturi në shtëpinë e re. Në fshatin Zym të rajonit të Hasit të Prizrenit, kumbara së pari e çon nusen në shtëpinë e zjarrit. Ajo tri herë i tund vargonjtë e vatrës, në grusht nuses ia qesin pak kripë, që simbolizon pasurinë, të cilën ajo e hedh pastaj në kusinë me mish. Disa veprime magjike-apotropeike kryhen me qëllim që nusja të ketë fëmijë, e posaçërisht djem, si trashëgimtarë të familjes. Nuses, ta zëmë, kur arrin në shtëpinë e dhëndrit, ende pa zbritur nga kali, ia vënë në prehër një djalë të vogël, të cilin e sjell tri herë rreth vetes, nga e majta në të djathtë. Asaj

gjithashtu i vënë në kokë tre plisa të dhëndrit. Ritet e tjera kryhen që nusja dhe dhëndri të mbrohen nga syri i keq dhe të ligat e tjera dhe të kenë një bashkëshortësi të lumtur.

Banorët e Kosovës besojnë në disa shenja që paralajmërojnë vdekjen: ëndrrat e liga, ulërima e qenit apo kënga e kukuvajkës. Kur e përcjellin të vdekurin nga shtëpia, në mes të dhomës vënë një tepsi me miell dhe mbi të një copë djathë, që i vdekuri të mos e marrë me vete “beregëtin” e shtëpisë. Vendin e stërpikun me ujë dhe e fshijnë me fshesë, për të penguar vdekjen tjetër në shtëpi. Një traditë karakteristike për mbarë viset e Kosovës është pjesëmarrja masive e njerëzve në varrim. Në këtë mënyrë shprehet pikëllimi dhe nderimi për të vdekurin, i cili lidhet me kultin e të parëve të familjes. Popullsia myslimane e Kosovës i viziton varrezat kryesisht të premtëve dhe në festa fetare, bie fjala në ditën e parë të Bajramit, ndërsa të krishterët i vizitojnë varrezat një herë në vit, më 2 nëntor. Në varreza ata ndezin qirinj dhe lënë ushqime për të vdekurit. Pas ceremonisë së varrimit zhvillohet e pamja, e cila së fundi zgjat 2-3 ditë.

Disa nga zakonet familjare janë zhdukur, disa kanë mbijetuar dhe disa syresh kanë mbetur vetëm në kujtesën e njerëzve të moshuar. (Shpresa Siqeca)

ZAKONORE (E DREJTA). Janë normat juridike të pashkruara, të cilat me shekuj janë krijuar nga populli. Me këtë të drejtë të pashkruar janë rregulluar marrëdhëniet nga fusha e së drejtës familjare, civile, penale dhe të lëmenjve të tjerë të marrëdhënieve juridike në jetën shoqërore. E drejta zakonore u paraqit në kohën kur nuk ekzistonte shteti, por për shkak të dobisë, një numër syresh vazhdoi të zbatohesh edhe pas krijimit të shtetit dhe pas nxjerrjes së ligjeve. Në mesjetë, madje, e drejta zakonore ka pasur fuqi juridike më të madhe se e drejta e shkruar. Pas konsolidimit të shtetit, një numër i konsiderueshëm i normave të së drejtës zakonore janë shndërruar në norma ligjore. Edhe te shqiptarët për shekuj me radhë janë sajuar nga populli norma të së drejtës zakonore. Shumica e normave të së drejtës zakonore shqiptare u emërtuan “kanune”. Termi kanun rrjedh nga greqishtja e vjetër “kanon”, term që u përhap edhe në gjuhë të tjera, si në atë turke. Në gjuhën shqipe termi “kanun” ka kuptimin e normave juridike të pashkruara,

të trashëguara brez pas brezi, me të cilat janë rregulluar çështjet nga fusha juridike civile, penale, familjare dhe lëmenjtë e tjerë. Varësisht prej periudhave dhe rajoneve shqiptare, e drejta zakonore shqiptare më së shpeshti është emërtuar kanun i një vendi ose i një personi të autoritetshëm, si: Kanuni i Lekë Dukagjinit, Kanuni i Skënderbeut, Kanuni i Lumës. Më rrallë, e drejta zakonore shqiptare është emërtuar edhe ndryshe, si p.sh. Zakoni i Musë Ballgjinit etj. (Ismet Salihu)

ZAKONORE SHQIPTARE (E DREJTA).

Përfshin tërësinë e normave të pashkruara, të transmetuara brez pas brezi, të cilat kanë rregulluar marrëdhëniet shoqërore në shumë krahina shqiptare. Është njëra nga të drejtat më të vjetra dhe më të veçanta në Europën e periudhës të shek. XV-XIX. Ajo nuk lindi nga një legjislator dhe as nga një parlament; ajo i parapriu shtetit, është e pashkruar dhe e transmetuar gojarisht nga një gjeneratë në tjetrën për gati 500 vjet radhazi. E drejta zakonore shqiptare mori emërtime të ndryshme në Veri dhe në Jug: në Veri u njoh kryesisht si kanun, kurse në Jug me termin venom. Veçantia e saj qëndron në faktin se ajo lindi në një kohë kur nuk ekzistonte shteti shqiptar, si njësi territoriale me një organizim institucional. Ruajtja e së drejtës zakonore për një kohë aq të gjatë dhe përballimi prej saj i trysnive të së drejtës së shteteve pushtuese, janë shprehje e qëndresës së popullit shqiptar në mbrojtje të qenies, gjuhës dhe kulturës së tij. Në të drejtën zakonore shqiptare gjetën pasqyrim disa nga tiparet themelore të psikologjisë shoqërore të popullit shqiptar, si: nderi, besa, burrëria, mikpritja etj. Për një periudhë ajo u zbatua edhe në Shqipërinë e pavarur, krahas legjislacionit të tij, deri në vitin 1928, kur me ligj u ndalua zbatimi i saj i mëtejshëm.

Në të drejtën zakonore shqiptare ka gjurmë të ndikimit të normave të të drejtave të tjera, por tërësia e saj mbetet origjinale. Për studiuesit e të drejtës zakonore kanuni dhe e drejta zakonore shqiptare përbën një kuriozitet sesi ajo përfshin në një vend një larmi të së drejtës penale, administrative, civile, kishtarë, private dhe publike. Burimi kryesor për studimin e të drejtës zakonore shqiptare janë kanunet e mbledhura, të cilat kanë vepruar në krahina të ndryshme të vendit: Kanuni i Lekë Dukagjinit, i Skënderbeut, i Labërisë etj. Kanuni i parë i

mbledhur është Kanuni i Lekë Dukagjinit, i kodifikuar nga Shtjefën Gjeçovi. Është e ndarë në 12 libra ose kapituj, ku secili prej tyre trajton një çështje që mund të klasifikohen nga e drejta private, tek ajo familjare, penale etj. Libri i parë trajton kishën, i dyti familjen, i treti martesën, libri i katërt shtëpinë dhe pronën dhe sipas radhës: punën, huat, dëmet, gjakmarrjen etj. (Bashkim Lajçi)

ZAPLLUZHA Adem (1943). Shkrimtar. Lindi në Prizren. Kreu shkollën fillore dhe gjimnazin në vendlindje dhe Akademinë Pedagogjike në Prishtinë. Një kohë punoi si mësues në fshatrat Studençan të Therandës dhe Hoça e Qytetit, afër Prizrenit. Nga viti 1971 e deri më 1996, kur u pensionua, punoi si përkthyes në Korporatën Energjetike të Kosovës. Rrugën letrare e nisi me vjersha për fëmijë që në vitet '50. Shkroi poezi për të rritur, poezi për fëmijë dhe poezi satirike dhe humoristike. Botoi libra me poezi "Ecjet e viteve të mëdha" (1995) dhe "Morfologjia e dhembjes" (2000), pastaj librat me poezi për fëmijë "Asgjë sikur molla" (2009) dhe "Fëmijët e erës" (2012) dhe librat me poezi humoristike e satirike "Don Kishoti dhe Rosinanti" (2010) dhe "Bajraktarët e vatani" (2010). (Hasan Hasani)

ZARBICA Sylë (1898-1946). Luftëtar anti-komunist. Lindi në Zarbicë të Malësisë së Bujanocit. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, u gjend në anën e forcave nacionaliste, si bashkëluftëtar i Idriz Hajrullahut, në mbrojtje të kufirit të Kosovës Lindore. Një kohë ishte komandant i xhandarmërisë në Karaçevë. Më 1944 u caktua komandant i forcave vullnetare në Kamenicë. Mori pjesë në betejën e Velegllavës dhe të Kikës (1944). Në dhjetor të vitit 1944 vullnetarët e tij u përballën me Brigadën XVII Maqedone dhe, pas luftimeve që u zhvilluan në Desivojcë, forcat maqedone u detyruan të largohen në drejtim të Gjilanit. Mori pjesë edhe në planifikimin dhe organizimin e luftës së Gjilanit më 23 dhjetor 1944. Pas dështimit u tërhoq në drejtim të Malësisë së Bujanocit dhe u strehua në fshatrat e asaj ane. Pas shumë përpjekjeve, OZN-a arriti ta zbulojë vendndodhjen e tij në fshatin Gjergjec të komunës së Bujanocit, ku edhe u vra në verën e vitit 1946. (Naim Musliu)

ZARBINCA. Fshat në komunën e Bujanocit. Është vendbanim rural i tipit blegtoral-agrar.

Në aspektin fizionomik i takon tipit të shpërndarë. Ndodhet në pjesën burimore të lumit të Zarbincës, degë kryesore e lumit të Tërrnocit. Shtrihet ndërmjet 900 dhe 1000 m të lartësisë mbidetare. Sipërfaqja e territorit të fshatit është 1,827 ha. Derisa në vitin 1961 Zarbinca kishte 1,354 banorë, tani më ajo është zbratur pothuajse plotësisht. Mungesa e infrastrukturës, izolimi, situata politike dhe konflikti i armatosur janë shkaktarët kryesorë të kësaj boshatisjeje. Popullsia e shpërngulur u vendos kryesisht në Gjilan. Nga objektet e standardit shoqëror, fshati ka shkollën fillore, bibliotekën etj. Është qendër e bashkësisë lokale për fshatrat Novosellë e Epërme, Priboc dhe Suharnë. (Arsim Ejupi)

ZARIQI Hilmi (1914-1952). Pjesëmarrës i Lëvizjes Antifashiste Nacionalçlirimtare, veprimtar i Lëvizjes Nacional-Demokratike Shqiptare. Lindi në Bajicë të Drenicës. Pas Luftës së Dytë Botërore u emërua kryetar komune në Glllogoc e pastaj kryetar i Këshillit Popullor të Rrethit të Skënderajt. Pas zhgënjimit me politikën jugosllave, u rreshtua kundër pushtetit. Ndihmoi grupet e rezistencës kombëtare që vepronin në kuadër të LNDH-së. U arrestua në vjeshtë të vitit 1945. U arratis nga burgu i Prishtinës dhe u vu në krye të LNDSH-së të rrethit të Drenicës. Bashkëpunoi me Ajet Gurgurin dhe Gjon Serreqin. Ishte njëri nga udhëheqësit e organizatës nr. 2, e cila vepronte brenda LNDSH-së. U angazhua në përgatitjen e programit të Kongresit V të LNDSH-së në Lipovicë (Blinajë). Aktiviteti i tij zbulohet nga organet e OZN-ës dhe u arrestua në nëntor të vitit 1946 në fshatin Tërstenik. Një vit më vonë Gjukata e Qarkut në Prizren e dënoi me vdekje. Dënimi me vdekje iu zëvendësua me 20 vjet burg. U vra më 1952, duke tentuar të ikte nga Burgu i Stara Gradishkës në Kroaci. (Sulltane Ukaj)

ZASE Hans-Jyrgen (Hans-Jürgen Sasse) (1943-2015). Gjuhëtar gjerman. Lindi në Berlin, ku kreu edhe shkollimin. Studioi gjuhësi të përgjithshme, indoeuropianistikë, semitistikë dhe ballkanistikë në Berlin, Selanik dhe Munnih. Doktoroi në Munnih. Pas habilitimit u zgjodh profesor dhe më vonë drejtor i Institutit të Gjuhësisë të Universitetit të Këlnit. U mor me shumë fusha të gjuhësisë, si me ato të gjuhësisë së përgjithshme, të gjuhësisë indoeuropiane, të gjuhësisë semite dhe të gjuhësisë ballkan-



HANS-JYRGEN
ZASE

ike. Shquhet si studiues i të folmeve arvanite të Greqisë me veprat: “Një dialekt arkaik shqip nga ujdhesa Andros” (Ein archaischer albanischer Dialekt auf der Insel Andros, 1982), “Arvanitika I” (1991) etj. Vepra e tij e fundit në këtë fushë paraqet përshkrim të gjerë dhe të plotë të strukturës së të folmeve arbëreshe të Greqisë, duke nxjerrë në pah dhe aspekte të ndryshme të shtresëzimit kohor. (Imri Badallaj)

ZASKOCI Ramadan (1860-1914). Luftëtar i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe i lëvizjes për çlirimin kombëtar. Mori pjesë në aksionin kundër Mehmet Ali Pashë Maxharit, duke vrarë telegrafistin e tij në Prizren, dhe në luftimet e Gjakovës (1878). Në nëntor 1879 dhe janar 1880 mori pjesë në luftën e forcave të Lidhjes për mbrojtjen e tokave shqiptare nga sulmet serbo-malazeze dhe në qëndresën kundër ushtrisë osmane në Shtime, Slivovë, Prizren (1881). Mori pjesë në organizimin e kryengritjes kundërosmane në Lumë në vitin 1910 dhe 1912. Në vitet 1912-1913 luftoi kundër pushtuesve serbë. Në shtator të vitit 1914, derisa po nisej për në Bicaj për lidhjen e një bese në ruajtjen e kufijve dhe çlirimin kombëtar, u vra në një pritë. (Fitim Rifati)

ZATRIQI Agim (1950-2016). Politikan, drejtor shumëvjeçar i Radiotelevizionit të Kosovës. Lindi në Prishtinë në vitin 1950, ku kreu shkollimin fillor dhe të mesëm. U diplomua në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës. Në vitet shtatëdhjetë të shekullit të kaluar ishte aktivist politik i rinisë së Kosovës (kryetar i Konferencës së Rinisë Socialiste të Kosovës) dhe të ish-Jugosllavisë dhe anëtar i Komitetit Krahinor të Lidhjes Komuniste të Kosovës. Pas zhvillimeve të vitit 1981 u shkarkua nga funksionet politike dhe u emërua drejtor i Radiotelevizionit të Prishtinës (RTP). Me përfundimin e luftës në Kosovë dhe me themelimin e Radiotelevizionit të Kosovës, nga viti 2001 deri më vitin 2011 ishte drejtor i parë i përgjithshëm i Radio-Televizionit të Kosovës (RTK), në periudhën kur ky institucion publik udhëhiqej nga bordi drejtues i përbërë nga vendorët dhe ndërkombëtarët. (Blerim Reka)

ZATRIQI Ali (1929-2009). Mjek, kirurg i përgjithshëm dhe abdominal, profesor universiteti. Lindi në Novi-Pazar, shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Prishtinë. U diplomua në



ALI ZATRIQI

Fakultetin e Mjekësisë në Beograd (1960). U kthye në Novi-Pazar dhe punoi dy vjet si mjek i përgjithshëm. Kreu specializimin për kirurgji në Beograd dhe sërish u kthye në vendlindje, ku punoi deri më 1971. Në këtë vit u zgjodh asistent në Universitetin e Prishtinës. Temën e magjistraturës e mbrojti në Beograd, ndërsa tezën e doktoratës në Prishtinë (1977). Për aftësim onkologjik qëndroi një vit në SHBA. Në vitin 1979 themeloi repartin e parë onkologjik në Kosovë. Më 1983 u zgjodh profesor inordinar, kurse profesor ordinar në vitin 1987. Mori pjesë në shumë kongrese e simpoziume dhe publikoi një sërë punimesh shkencore-profesionale, si autor dhe bashkautor. Botoi dy tekste të kirurgjisë: “Kirurgjia e përgjithshme dhe kirurgjia e luftës” dhe “Kirurgjia speciale”. Dha kontribut të madh në organizimin e shërbimit kirurgjik gjatë luftës së fundit në Kosovë. Më 1998, në Likoc organizoi spitalin kirurgjik për të plagosur. Më 1999 u kthye në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, si koordinator i Klinikës Kirurgjike, ku vazhdoi mësimdhënien tij deri në fund të jetës. (Avdyll Krasniqi)

ZEFI Dom Shan 1959-). Prift katolik, studiues i historisë. Lindi në Dunav të Gjilanit. Shkollën fillore e krye në vendlindje, gjimnazin klasik në Suboticë (Serbi), ndërsa studimet filozofike-teologjike i vazhdoi te jezuitët në Zagreb, ku u diplomua për filozofi dhe teologji. Pas studimeve u shugurua meshtar në Ferizaj (1987) dhe u emërua vikar i famullisë. Pas një viti u dërgua për studime pasuniversitare në Romë, në Universitetin Papnor “Urbaniana”, ku kreu studimet e magjistraturës dhe dy vjet më vonë mbrojti tezën e disertacionit të doktoratës. Me t’u kthyer në Kosovë u emërua kancelar i Ipeshkvisë së Kosovës dhe kryetar i gjyqit kishtar me seli në Prizren. Gjatë kësaj kohe, përveç misionit të meshtarit, u mor edhe me dialogun ndërfaqetarak dhe ekumenik. Botoi librin studimor “Islamizimi i shqiptarëve gjatë shekujve” (shqip, kroatisht dhe anglisht). Ishte

njëri ndër më të përkushtuarit për ndërtimin e Katedrales “Nënë Tereza” në Prishtinë. Aktualisht është kancelar, famullitar dhe vikar i Ipeshkvisë së Prizrenit. (Ndue Ukaj)

ZEJNELI Ramadan (1952-1993). Lindi në Shkup. Mësimet e para i mori në qytetin e lindjes. Po aty mbaroi shkollën e mesme dhe studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe. Punoi mësues në fshatin Luboten të Shkupit. Shkroi poezi e prozë, për të rritur dhe për fëmijë, por edhe drama për fëmijë. Disa nga librat e tij për fëmijë janë: “Kërmilli argjendar” (1977), “Treni me njëqind zemra” (1978), “Kopraci i Mbretërisë së Hënës” (1982), “Margaritarët e humbur” (1982), “Lazdrani i liqenit” (1983), “Peshku filozof” (1983), “Ujku me zile” (1987), “Flutura e pranverës sime” (1989) etj. Vdiq në Shkup. (Xhevat Sylja)

ZEJNULLAHU Abdullah (1957-). Matematikan, profesor universiteti. Lindi në Ramjan, komuna e Vitisë, ku kreu shkollën fillore, ndërsa gjimnazin matematikor e kreu



ABDULLAH ZEJNULLAHU

në Prishtinë. Studimet e matematikës i kreu në vitin 1980, studimet pasuniversitare i përfundoi në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore (FSHMN) të Universitetit të Beogradit (1983), ndërsa tezën e disertacionit e mbrojti në FSHMN të Universitetit të Prishtinës (1989). Për studim specializimi ka qëndruar në Universitetin “Karllovo” të Pragës. Është autor dhe bashkautor i punimeve shkencore dhe profesionale të botuar në revistat vendore e ndërkombëtare. Mori pjesë me kumtesa në tubime shkencore në vend dhe jashtë. Është autor i teksteve të shkollave të mesme dhe bashkautor i teksteve universitare (“Matematika III” dhe “Matematika për studentët e arkitekturës”). Ka kryer detyra me rëndësi në institucionet e arsimit të lartë të Kosovës. (Minir Efendija)

ZEJNULLAHU Adem (1945-). Mbledhës dhe studiues i folklorit, poet. Lindi në Banjaskë të Vushtrrisë. Kreu Shkollën Normale në Mitrovicë, ndërsa studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës. Studimet pasuniversitare dhe

doktoratën nga fusha e shkencave filologjike i kreu po në UP (1986). Deri më 1982 punoi si mësimdhënës i gjuhës dhe i letërsisë shqipe në shkollë të ndryshme në Prishtinë e në Mitrovicë. Në periudhën 1982-2010 punoi në Institutin Albanologjik të Prishtinës si këshilltar shkencor dhe përgjegjës i degës së folklorit për disa vjet. Botoi disa monografi dhe përmbledhje studimore për folklorin: “Krijimtaria gojore dhe proza e shkruar shqiptare në Jugosllavi” (1978), “Disa venerime për poezinë popullore” (1996), “Hulumtime në letërsinë popullore” (2005), “Dhembja dhe flijimi në baladat popullore” (2014) etj. Është bashkautor në përgatitjen e vëllimeve me materiale folklorike “Këngë kreshnike II” (1991), “Këngë popullore historike I, II, III, IV” (2007), “Fabula” (2008) etj. Ka botuar edhe disa përmbledhje poetike: “Kur zgjohen ernalt” (1969), “Mote hiri” (2000), “I vetëm me ëndrrën” (2007), “Dhembje shiu” (2012) etj. Ka marrë pjesë me kumtesa në disa tubime shkencore për çështje të folklorit brenda dhe jashtë vendit. (Leontina Musa)

ZEJNULLAHU Hakif (1962-1997). Pjesëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Hero i Kosovës. Lindi në fshatin Lladofc të Podujevës. Pasi kreu shkollën fillore në vendlindje, shkollën e mesme në Podujevë, u regjistrua në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore në Universitetin e Prishtinës. Ishte aktiv në të gjitha zhvillimet politike që nga fillimi i viteve '80, si pjesëmarrës në demonstrata, greva dhe protesta. Bashkë me Zahir Pajazitin në fillim të viteve '90 u angazhua për organizimin e rezistencës aktive të armatosur. Për këtë qëllim, shtëpia e tij në Lladofc u shndërrua në njërin nga bazat e para të UÇK-së. Me qëllim të furnizimit me armatim, së bashku me Zahir Pajazitin, udhëtoi disa herë në Shqipëri. U vra në një pritë të organizuar nga forcat serbe më 31 janar të vitit 1997 në fshatin Pestovë të komunës së Vushtrisë, bashkë me Zahir Pajazitin dhe Edmond Hoxhën. Nga presidenti i Republikës së Kosovës më 2012 u dekorua me Urdhrin “Hero i Kosovës”. (Ismet Cakiqi)

ZEJNULLAHU Jonuz (1975-1999). Luftëtar, dëshmor. Lindi në fshatin Skifteraj të komunës së Vitisë. Kreu Medresenë “Alaudin” në Prishtinë. Në vitin 1995 u caktua imam në fshatin Drobesh, kurse një vit më vonë në fshatin e tij të lindjes. Më 1996 filloi studimet për teologji në

Damask të Sirisë. U arrestua pas demonstratës së 15 marsit 1998, që u mbajt në përkrahje të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Në fillim të vitit 1999, së bashku me një grup luftëtarësh, kaloi përmes maleve të Karadakut, për të shkuar në Kumanovë dhe më pas për t'iu bashkuar luftëtarëve që luftonin në kufirin Shqipëri-Kosovë. Më 20 prill të vitit 1999 u inkuadrua në Brigadën 138 “Agim Ramadani”, e cila luftonte në Koshare. Më 5 maj 1999 hoxhë Januzi mori plagë të rënda dhe vdiq në betejë. (Halim Emërllahu)

ZEJNULLAHU Jusuf (1944-). Politikan. Lindi në Svirçë të Medvegjës (Serbi), ku kreu shkollimin parauniversitar, mbaroi studimet në Fakultetin Ekonomik në Prishtinë dhe më pas kreu studimet pasuniversitare në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Zagrebit. Në fillim punoi në Sekretariatit për Ekonomi të Këshillit Ekzekutiv të KSA të Kosovës, në Drejtorinë për Komunikacion dhe Lidhje, për të vazhduar në detyrën e këshilltarit për ekonomi në Kuvendin e Kosovës. Më vonë emërohet drejtor i Entit për Zhvillimin Ekonomik të Prishtinës, nënkryetar i Odës Ekonomike të Kosovës, drejtor gjeneral i Kombinatit Metalurgjik “Ferronikeli”, nënkryetar i Odës Ekonomike të Jugosllavisë, me detyrë të koordinimit të politikës monetare dhe sistemit bankar. Në vitin 1989 zgjidhet kryetar i Këshillit Ekzekutiv të KSA të Kosovës, funksion që e ushtroi deri me zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës, pas shpalljes së Kushtetutës së Kaçanikut, më 7 shtator 1990. Jeton në SHBA. (Ali Cenaj)

ZEJNULLAHU Nuredin (Cekë) (1949-1998). Mjek, internist, dëshmor. Lindi në Pejë, shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në Pejë, Fakultetin e Mjekësisë në Beograd. Punoi në Pejë, në Spitalin e Përgjithshëm. Në Beograd përfundoi specializimin në fushën e mjekësisë interne. Me shpërthimin e luftës në Kosovë, u angazhua për sigurimin e barnave dhe të pajisjeve të tjera të nevojshme për mjekimin e të plagosurve. Në mbremjen e 19 nëntorit të vitit 1998 persona të maskuar kishin hyrë në shtëpinë e tij dhe në prani të familjarëve e ekzekutuan mizorisht. Për merita të veçanta në ndihmë luftëtarëve të lirisë dhe popullatës civile në rrethana lufte, Shoqata e Mjekëve të Kosovës, pas vdekjes, e nderoi me mirënjohje të veçantë. (Ibrahim Rexhaj)

ZEJNULLAHU Ramadan (1957-). Matematikan, profesor universiteti. Lindi në Llapashicë të Poshtme të Podujevës. Shkollën fillore e kreu në Podujevë, gjimnazin matematikor në



RAMADAN
ZEJNULLAHU

Prishtinë dhe në vitin 1980 u diplomua në departamentin e matematikës të Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore (FSHMN) të Universitetit të Prishtinës (UP). Kreu studimet pasuniversitare po në FSHMN të UP-së (1984), ku më 1987 mbrojti edhe tezën e disertacionit të doktoratës. Zgjidhet asistent në departamentin e matematikës të FSHMN-së (1981) dhe në vitet vijuese i merr të gjitha gradat universitare. Botoi punime shkencore në revista vendore dhe ndërkombëtare, tekste për shkollë të mesme dhe tekste universitare (“Analiza funksionale”, “Analiza matematike I”, “Kurs i matematikës së lartë” etj.). Qëndroi për vizita studimore jashtë vendit dhe kreu detyra me rëndësi në institucionet e arsimit të lartë të Kosovës, përfshirë edhe atë të rektorit të UP-së. (Minir Efendija)

ZEJNULLAHU Safet (1967-). Gazetar. Lindi në Lladofc të Podujevës. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Lladofc dhe në Podujevë. Studimet për letërsi i kreu në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës. Në fillim punoi gazetar dhe redaktor në gazetën e studentëve “Bota e re”, pastaj gazetar dhe redaktor në Qendrën për Informim të Kosovës (QIK) dhe redaktor në gazetën ditore “Zëri”. Bashkëpunoi me një sërë gazetash e revistash. Është autor i librit “Lufta për Kosovën” (2000) dhe i librit universitar “Shkrimi dhe komunikimi” (2014). Është bashkautor i librit “Gjuha e stuhisë”, në të cilin janë përmbledhur tekstet autoriale të Enver Malokut shkruar në gazetën e mbrëmjes “Informatori”, si dhe i librit “Presidenti Sejdiu”, botim i Zyrës së presidentit të Kosovës. Është redaktor i disa botimeve të QIK-ut nga fusha të ndryshme. Është drejtor i departamentit të informimit në zyrën e presidentit të Kosovës. (Ibrahim Berisha)

ZEJTARIA MESJETARE. Në kohën e Bizantit, krahas prodhimeve të produkteve bujqësore u zhvillua edhe zejtaria, sidomos me formimin e

aristokracisë së re, nevojat e së cilës rriteshin vazhdimisht. Ndërkohë, veprimtaritë zejtare rritën prodhimin e tyre, sidomos për elitën ushtarake, por edhe për nevojat e tregut. Në shumë vendbanime metalpunuesit (demirxhit), prodhonin pjesë për vegla pune dhe armatim për nevojat e ushtrisë. Nëpër qytete u paraqitën kasapë, bukëpjekës, këpucarë, bojaxhi, kafexhinj, terzi e rrobaqepës, tabakxhi etj. Ardhja e sasëve në Ballkan ndikoi dukshëm në zhvillimin e xehetarisë dhe të zejtarisë. Në shek. XIV u zhvilluan qendra xehetare, të cilat i vizitonin shumë tregtarë nga vise të ndryshme, sidomos nga Raguza dhe Kotorri. Xeheroret e Novobërdës gjatë shek. XIV-XV krijuan mundësi për zhvillimin e qytetit, ku, përveç xehetarisë, u zhvilluan lloje të ndryshme të zejeve. Produktet e xeheve të Novobërdës, Trepçës, Janjevës etj., tërhiqnin shumë tregtarë të huaj. Materialet arkeologjike, në radhë të parë monedhat nga metali, dëshmojnë për një standardizim të prodhimeve zejtare. Mbreti Stefan Deçani i kishte dhuruar Manastirit të Deçanit një pjesë të prodhimeve të hekurit nga Gluhavica e Kopaonikut. Kjo xeherore ishte aktive nga fillimi i shek. XIV, përfshirë edhe një periudhë të sundimit osman. Gjithashtu, disa manastire kishin xeheroret e veta të shoqëruar me shkritore. Në këtë kuadër duhet përmendur Manastiri i Deçanit, ku ishte ngritur shkritorja e re e xeheve për hekur në krahinën e Altinit. Edhe Manastiri i Shenjtorëve Mëhill dhe Gabriel në rrethinën e Prizrenit kishte minierën dhe shkritoren e vet të hekurit. Produktet e xeheve shfrytëzoheshin nga vendorët, por edhe nga bizantinët, sasët dhe më vonë nga raguzanët, kotorrrasit etj. (Hamdi Mediu)

ZEJTARIA. Tërësia e zejeve që merren me prodhimin e objekteve për përdorim të përditshëm dhe solemn, të realizuar nga mjeshtrë të specializuar. Zejtaria në Kosovë ishte e zhvilluar që në kohët më të hershme, pastaj në mesjetë dhe më vonë, sidomos në shekujt XVIII-XIX. Në këtë periudhë disa qytete kishin deri në 1,000 dyqane. Qytetet më të rëndësishme zejtare ishin: Prizreni, Peja, Gjakova, Prishtina, Mitrovica, Janjeva, Gjilani, Vushtrria etj. Zejet më të rëndësishme ishin të armëpunuesve, të thikëpunuesve, argjendarëve, tabakëve, saraçëve, terzinjve, kazazëve, kazanxhinjve, nallbanëve, orëtarëve, jorganxhinjve, mutavxhivë, samarxhinjve etj.

Në shekullin XIX Prizreni u bë qendra më e madhe e punimit të armëve në Ballkan dhe qendër e njohur e argjendarisë. Zejtarët e Prizrenit punonin pushkë, kobure, shpata, jataganë, brisqe dhe stoli. Peja, Prizreni dhe Gjakova u përmendën për zejet e tabakëve, prodhimet e të cilëve i përdornin çyrkçinjtë, saraçët dhe papuçehinjtë. Në këto qytete ishin të zhvilluara edhe zejet e terzinjve dhe të kazazëve, që merreshin me qepjen dhe qëndisjen e veshjeve popullore. Zejet e kazanxinjve dhe të poçarisë ishin të zhvilluara sidomos në Prishtinë dhe Gjilan. Zejtarët punonin enë bakri, mesingu dhe dheu. Zejet e qeleshepunuesve dhe çibukçinjtë ishin të zhvilluara më së shumti në Gjakovë. Zejet e Kosovës ishin të organizuara në esnafe qysh në mesjetë, me qëllim të mbrojtjes së interesave të zejtarëve. Esnafet më të rëndësishme ishin ato të tabakëve, terzinjve, argjendarëve, armëpunuesve, thikëpunuesve etj. Ekzemplarët e zejeve janë të stolitur me ornamente zoomorfe, gjeometrike, florale, kozmike, spiraloide dhe ornamente të tjera. Disa zeje në Kosovë tashmë janë shuar dhe disa të tjera janë në prag të zhdukjes. (Shpresa Siqeca)

ZEKA Haxhi (1832-1902). Atdhetar, tribun popullor, themelues i Lidhjes së Pejës. Lindi në fshatin Shoshan të Malësisë së Gjakovës, prej nga më pas bashkë me familjen u shpërngul



HAXHI ZEKA

në qytetin e Pejës. Kreu mejtepin në Pejë dhe Medresenë e Madhe të Gjakovës. Që në rininë e hershme u përfshi në aktivitete antiosmane. Ishte një nga organizatorët dhe pjesëmarrës në Kuvendin e Përgjithshëm të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit më 10 qershor të vitit 1878 dhe, si përfaqësues i nahijes së Pejës, u zgjodh anëtar i Komitetit Qendror të Lidhjes. Dha kontribut në konsolidimin e ushtrisë së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe të institucioneve të tjera në degën e Lidhjes në Pejë. Mori pjesë në aksionin ushtarak kundër Mehmet Ali Pashë Maxharrit në Gjakovë në muajin shtator të vitit 1878 dhe, në fund të vitit 1879 dhe në fillim të vitit 1880, mori pjesë në luftimet për mbrojtjen e Plavës dhe të Gucisë kundër forcave ushtarake të Malit të Zi. Pas shuarjes së Lidhjes

Shqiptare të Prizrenit, Haxhi Zeke, së bashku me Sylejman Vokshin dhe atdhetarë tjerë, gjatë periudhës 1884-1885 udhëhoqën kryengritjet e shqiptarëve kundër Portës së Lartë. Ai u qëndroi besnik ideve autonomiste të Lidhjes së Prizrenit dhe ishte përkrahës i bashkimit të forcave shqiptare, pa dallime fetare dhe krahinore. Në vitin 1893, në bashkëpunim me Bajram Currin, organizuan dhe udhëhoqën kryengritjet antiosmane në rrethinën e Pejës dhe të Gjakovës. Gjatë muajve shkurt-mars të vitit 1897, hodhi themelet e një lidhje të re, e cila më pas u njoh si "Besëlidhja shqiptare". Pas konsultimeve me Komitetin Shqiptar të Stambollit, i cili udhëhoqej nga Sami Frashëri, H. Zeke thirri Kuvendin e Pejës, i cili i zhvilloi punimet nga 23-29 janar 1899. Në këtë kuvend u themelua Lidhja Shqiptare e Pejës, e njohur ndryshe si "Besa-Besë", me kryetar H. Zekën. Ai mori përsipër organizimin e forcave ushtarake për të mbrojtur tokat shqiptare nga sulmet e Serbisë, Malit të Zi, Bullgarisë dhe Greqisë. Aktivitetet e tij shqetësuan Perandorinë Osmane, Serbinë dhe Malin e Zi. U vra më 21 shkurt të vitit 1902 në një atentat të organizuar nga Serbia. (Frasher Demaj)

ZEKA Kadri (1953-1982). Veprimtar i lëvizjes ilegale, Hero i Kosovës. Lindi në fshatin Polliçkë të Kamenicës. Shkollën fillore e kreu në Desivojcë, kurse shkollën e mesme në Gjilan.



KADRI ZEKA

Punoi si mësues në shkollën fillore të Gmicës dhe gazetar në Radio-Prishtinë. Më 1978 kreu studimet në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës, degën e gazetarisë. Në mars të vitit 1978, meqë kishte rënë në sy të organeve të pushtetit veprimtaria e tij ilegale, ik për disa javë në Turqi dhe pas rikthimit ilegal në Kosovë migron në Zvicër. Atje angazhohet në organizimin e mërgatës kosovare. Përgatiti botimin dhe shkroi artikuj për gazetën "Liria". Nën përkujdesjen e tij mijëra ekzemplarë të publikimeve ilegale u shpërndanë në Kosovë dhe në hapësirat e tjera shqiptare në ish-Jugosllavi. Bashkëpunoi me vëllezërit Gërvalla, me qëllim të bashkimit të organizatave shqiptare në një front të përbashkët. U angazhua në organizimin e protestave të emigracionit

politik dhe të punëtorëve shqiptarë me punë të përkohshme në shtetet e Europës Perëndimore. Sensibilizoi opinionin për kërkesat e demonstratave të vitit 1981 në Kosovë. U vra afër Shtutgardit në Gjermani, së bashku me vëllezërit Gërvalla, në një atentat që u krye nga agjentët e UDB-ës jugosllave. (Zijadin Gashi).

ZEKA Milaim (1962-). Gazetar. Lindi në Abri të komunës së Skënderajt, ku kreu shkollën fillore. Shkollën e mesme e kreu në Drenas dhe më pas në Kijevë. Mbaroi studimet për shkencë politike në Universitetin e Prishtinës. Në vitin 1981, për shkak të aktivitetit politik, burgoset dhe më pas arratiset jashtë vendit. Nga viti 1983 deri më 1990 punoi si korrespondent nga Zvicra për gazetën “Zëri”, ndërsa në periudhën 1989-1990 në Ministrinë e Drejtësisë të Mbretërisë së Norvegjisë dhe më pas (1987-1999) punoi si ekspert për Ballkanin në Ministrinë e Jashtme të Suedisë. Gjatë viteve 1989-1999 ishte korrespondent nga Europa për Radiotelevizionin Shqiptar (RTSH) dhe për programin për Kosovën në RTSH. Njëkohësisht në periudhën 1991-2000 ishte gazetar në Radion publike të Suedisë. Gjatë luftës në Kosovë dhe menjëherë pas saj ishte korrespondent për një numër mediesh ndërkombëtare. Është autor i emisionit debatus dhe hulumtues “Pa rrotulla”, që transmetohet në Radiotelevizionin e Kosovës. Është edhe autor i disa dokumentarëve televizivë. (Rahman Paçarizi)

ZEKA Naip (1952-). Inxhinier i metalurgjisë, aktivist politik. Lindi në fshatin Dumnicë e Poshtme të Podujevës. Shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në Podujevë, ndërsa studimet në Fakultetin e Xehetarisë dhe të Metalurgjisë në Mitrovicë (1978). U punësua në “Ferronikel” në Drenas si inxhinier në investime, si teknolog kryesor dhe si drejtor i shkrites së “Ferronikelit”. Përveç kësaj, dy vjet (1984-1986) ishte i angazhuar si mësimdhënës për lëndët fundamentale nga lëmi i metalurgjisë në Fakultetin e Xehetarisë dhe të Metalurgjisë në Mitrovicë. Është kontribues në ridizajnimin e teknologjisë së përfimit të ferroniklit nga xeheroret silikate, duke e zëvendësuar koksmin me linjitet vendore në procesin e kalcinimit të xeherorit lëndor, si dhe në hulumtimin e mundësive të prodhimit të ferronikelit nga xeheroret në Republikën e Shqipërisë. Pas

vitit 1999 ishte kryetar i bordit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale. Në vitin 1991 ishte i burgosur nga regjimi i Serbisë me grupin e intelektualëve kosovarë. Ishte pjesëmarrës i bisedimeve në Rambuje, në cilësinë e koordinatorit të grupit të ekspertëve në kuadër të delegacionit të Kosovës. (Shyqeri Kelmendi)

ZEKOLLI Ferit (1951-). Basketbollist. Lindi në Maxhunaj të Vushtrrisë. Nisi karrierën në KB “Trepça” të Mitrovicës në fillim të viteve ‘70. Në edicionin 1972/73 kaloi në radhët e KB



FERIT ZEKOLLI

“Universiteti”, i cili më pas fuzionohet dhe merr emrin “Elektrokosova”, skuadër me të cilën luajti në ligën e dytë të ish-Jugosllavisë. Kulmin e karrierës e arriti në KB “Zara” (kampion i pesëfishtë i ish-Jugosllavisë), në edicionin 1977/78. Derisa ishte basketbollist i KB “Zara”, F. Zekolli pësoi një lëndim të rëndë në këmbë, gjë që pati ndikim në karrierën e tij. Pas kthimit në Kosovë, u bë pjesëtar i KB “Prishtina”. Karrierën e përfundoi aty ku e kishte nisur në KB “Trepça”. Pas luftës, për një mandat, kreu detyrën e drejtorit të departamentit të sportit të Kosovës në kuadër të Ministrisë së Kulturës, të Rinisë dhe të Sportit. (Bekim Aliu)

ZENDELI Halil (1946-). Shkrimtar, gazetar, botues. Lindi në Llakavicë të Gostivarit. Kreu studimet për gjuhë e letërsi shqipe në Fakultetin Filozofik në Prishtinë. Fillimisht punoi



HALIL ZENDELI

në arsim, në Reçan e Sërmnovë të Gostivarit. Një kohë punoi në gjimnazin e Vitisë dhe të Ferizajt. Në periudhën 1975-2003 punoi në botimet e “Flakës së vëllazërimit” në Shkup, ku ka qenë lektor, redaktor përgjegjës në redaksinë e botimeve, redaktor përgjegjës i gazetës për fëmijë “Fatosi”, redaktor në faqet e kulturës të gazetës “Flaka”, redaktor përgjegjës i revistës “Jehona” dhe zëvendëskryeredaktor i ndërmarrrjes. Nga viti 2003 drejton Shtëpinë Botuese “Vatra” në Shkup, në kuadër të së cilës botohet

revista për kulturë, art e shkencë “Jehona e re”. Është autor i dramave: “Shkëndija të rritura në diell”, “Qëndrinë”, “Shokët e burrit”. Dy drama të tij janë vënë në skenën e teatrit “Sandër Prosi” në Mitrovicë. Ka botuar përmbledhjet me tregime: “Mjegullinë”, “Shëngjergj pa nuse”, “Djajtë nuk vdesin”, “Vite çmendurie”. Është autor i monografisë “Nobelisti Ferid Murati - krenaria jonë”. Ka përgatitur dhe botuar librat “Tregime, përralla e legjenda” (leksikon i vogël i shkrimtarëve për fëmijë), “Heronjtë e heshtur” (roman) dhe “Pikëpamje dhe reagime” (artikuj, reagime, reportazhe). Është fitues i çmimeve dhe mirënjohjeve. (Fatmir Sulejmani)

ZENELI Abdullah (1952-). Botues, shkrimtar, publicist. Lindi në Siboc të Podujevës. Kreu shkollimin fillor dhe të mesëm në Prishtinë. Aty ndoqi edhe studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe. Për një kohë të gjatë punoi në Redaksinë e botimeve “Rilindja” në Prishtinë, më pas, më 1990 themeloi Shtëpinë Botuese “Buzuku”, duke u bërë njëri nga botuesit më të njohur dhe më të rëndësishëm të librit shqip në Kosovë dhe më gjerë. Krahas punës prej botuesi, u mor edhe me krijimtari letrare, duke shkruar letërsi për fëmijë dhe të rritur, por duke mbetur i përkushtuar në kultivimin e tregimit të shkurtër. Është autor i veprave: “Gryka e Drinit” (1990), “Odiseu i Bjeshkëve të Nemuna” (1997), “Toka shqiptare” (2000), “Vetmia e mermertë” (2016). Njihet edhe për shkrimet e tij publicistike nëpër revistat dhe të përditshmet tona. (Kujtim Rrahmani)

ZENELI Agim (1962-1999) Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), dëshmor. Lindi në Shqiponjë (Jabllanicë) të Dushkajës, komuna e Gjakovës. Një kohë jetoi e punoi në Zvicër, ku ra në kontakt me shumë veprimtarë që punonin për lirinë e Kosovës. Që nga mesi i vitit 1997 mori pjesë në aksione të armatosura kundër caqeve ushtarake-policore serbe dhe në furnizim me armatim nga Shqipëria. Në muajt prill-maj 1998 ishte komandant i vijës së parë në frontit Kralan-Kpuz-Çeskovë. Mori pjesë në luftimet frontale të zhvilluara në Sukë të Cërmjanit, pastaj në Gërgoc, Zhdrellë, Gllarevë, Volljakë, Sferkë, Gremnik, Grabanicë, Rahovec, Çifllak, Loxhë, në dy ofensivat në mbrojtje të Shqiponjës, në Zhebel, Bardhaniq, Buçan, Vranoc, Junik, Rakovinë, Ratish, etj. Disa herë u plagos në luftime. Në nëntor të

vitit 1998 u emërua komandant i batalionit të parë të Brigadës 132 “Myrtë Zeneli” të UÇK-së të Zonës Operative të Dukagjinit. Ra më 29 janar 1999 në Rogovë të Hasit, derisa ishte komandant i grupit në udhëtim, pasi kishte kaluar dy prita në Bishtazhin e Goden. (Faton Mehmetaj)

ZENELI Driton (1972-1998). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), dëshmor. Lindi në Gjakovë. Shkollën e mesme për aviacion e kreu në Rajlovc, afër Sarajevës, ku u diplomua për teknik të aviacionit. Shërbeu në aeroportin ushtarak në Gollubovc, afër Podgoricës, në Mal të Zi. Arriti të largohej nga ushtria jugosllave në vitin 1993, kur u kthye në Gjakovë, ku kreu Shkollën e Lartë Pedagogjike. Punoi si mësimdhënës në fshatrat Doblbare dhe Dol të Gjakovës deri në mars të 1998, kur iu bashkua radhëve të UÇK-së. Disa muaj veprroi në Glllogjan, si oficer në Shtabin Operativ të Rrafshit të Dukagjinit. Iu besua detyra e instruktorit për stërvitjen e rekrutëve të rinj. Më pas u emërua komandant në Shtabin e Jabllanicës. Mori pjesë në beteja të shumta. Në gusht të vitit 1998 u emërua komandant i Brigadës 132 “Myrtë Zeneli”. Njësitet e komanduara prej tij operonin në shumë fshatra të Dushkajës, Lugut të Baranit e deri në Sukë të Cërmjanit. Ra dëshmor më 8 shtator 1998, gjatë ofensivës së dytë të forcave serbe kundër Jabllanicës. (Manushe Ramosaj)

ZENELI Muhamet (1968-1999). Pjesëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), dëshmor. Lindi në fshatin Bob të Kaçanikut. Pas përfundimit të shkollimit emigroi në Gjermani, por në qershor 1998 u kthye në Kosovë dhe mori pjesë në organizimin e luftës dhe në furnizimin me armatim për luftëtarët e UÇK-së. Ishte pjesëmarrës i shumë betejave të UÇK-së në rrethinën e Kaçanikut, si në Gajre, Ivajë dhe në beteja e aksione të tjera. Më 9 prill 1999, në përballje me policinë dhe ushtrinë serbe në Rakoc, ra heroikisht me bashkëluftëtarët e tij Fadil Çaka, Nehat Çaka, Faruk Dogani, Ilir Zharku, Lumnije Raka, Jehonë Raka dhe Emsale Frangu. Është nderuar me mirënjohje dhe dekorata nga institucionet e Republikës së Kosovës. (Hajrush Kurtaj)

ZENKI Luan (1969-). Piktur. Lindi në Gostivar. Kreu shkollimin në Gostivar, ndërsa

studimet e larta për art figurativ në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. Një kohë punoi si mësime në shkollë fillore, pastaj në vitet 1995-2001 në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Tetovës. Ishte dhe mësime në kolegjin “Jahja Kemal” në Gostivar. Në vitin 2013 ishte drejtor i Qendrës për Kulturë në Gostivar. Gjatë karrierës së tij si artist, përpos që mori pjesë në disa ekspozita kolektive, realizoi projekte individuale në fushën e artit në disa galeri brenda dhe jashtë vendit. Ishte bashkëpunëtor në realizimin e disa projekteve për enterierët e xhamive dhe hapësirave hoteliere të realizuara në teknikën e mozaikut, freskopikturimit dhe vitrazhit. Jeton dhe vepron në Gostivar. (Jëldeze Asani)

ZENKU Meli (1944-). Pikturor. Lindi në Simnicë të Gostivarit. Kreu shkollimin e mesëm për art figurativ në Shkup. Po në Shkup mbaroi Akademinë Pedagogjike, ndërsa Akademinë e Arteve e kreu në Prishtinë (1978). Është anëtar i Shoqatës së Artistëve Figurativë të Maqedonisë nga vitit 1978, bashkëthemelues i Shoqatës Mbarëkombëtare të Artistëve Figurativ me seli në Tiranë, i Shoqatës “Draudakum” në Gostivar, i manifestimit “Qyteti i borës” në Mavrovë, njëri nga themeluesit e Universitetit të Tetovës (1994) me kontribut të veçantë për themelimin e Fakultetit të Arteve në këtë universitet. Është autor i disa përmendoreve: në fshatin Serrnovë të Gostivarit, në Qafë të Kërçovës, në Gradec të Vrapçishtit etj. Punoi në restaurimin e enterierëve të xhamive, të hapësirave hoteliere në Maqedoni, në shtete të ndryshme të Europës dhe në SHBA. Është fitues i disa çmimeve dhe mirënjohjeve publike. (Jëldeze Asani)

ZEQIRAJ Lendita (1972-). Piktore, regjisore. Lindi në Prishtinë. Kreu studimet për pikturë në Fakultetin e Arteve në Prishtinë (1994). Është anëtare e Shoqatës së Artistëve Figurativë të Kosovës, në ku-



LENDITA ZEQIRAJ

adër të së cilës mori pjesë në disa aktivitete të përbashkëta. Mbajti disa ekspozita individuale dhe mori pjesë në ekspozitat kolektive “Salloni Pranveror i Kosovës” (1996), “Bienalja e vizatimit” (1997),

Galeria “Te-Gi” në Tiranë (1997), “Java e kulturës kosovare” në Shtutgart (2000), Galeria “La Ferme du Lac”, Guenin në Francë etj. Më 2002 realizon filmin e shkurtër “Exit”, me të cilin mori pjesë në disa festivale ndërkombëtare dhe mori çmimet: “Grand Prix” në Kanë (2003), Çmimin e filmit më të mirë të shkurtër në “Lausanne Underground Film & Music festival”, çmimin për filmin më të mirë shqiptar në Festivalin Ndërkombëtar në Tiranë (2004), çmimin “Best Cinematography”, në Festivalin Ndërkombëtar të Filmit në Nju-Jork (2005), çmimin special të jurisë në Festivalin e Ndërkombëtar të Filmit në Kajro etj. Realizoi edhe një sërë filmash dokumentarë, videointalacione dhe filma të shkurtër. Filmi “Ballkoni” u shfaq në disa festivale dhe u shpërblye, përfshirë dhe çmimin special të jurisë në “AFI Fest” në Los Anxhelos. (Rexhep Ferri)

ZEQIRAJ Remzie (1967-). Luftëtare e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), oficerë e FSK-së. Lindi në Studenicë të Istogut. Gjatë viteve 1990-1998 ishte kryetare e Forumit Demokratik të Gruas dhe anëtare e kryesisë së degës së Lidhjes Demokratike të Kosovës në Istog. Nga marsi i vitit 1998 mori pjesë në organizimin e celulave të para të UÇK-së, pastaj në organizimin dhe konsolidimin e Brigadës 133 “Adrian Krasniqi” në Zonën Operative të Dukagjinit. Në janar të vitit 1999 u emërua ndihmëse e komandantit për informim e Brigadës 133. Raportoi për agjencinë e lajmeve “Kosovapress” dhe Radion “Kosova e lirë”. Në prill të vitit 1999, gjatë luftimeve u plagos, më pas u dërgua për shërim në Tiranë dhe në Gjermani. Pas trajtimit 6 mujor u kthye në Kosovë. Pas luftës u angazhua në Shtabin e Përgjithshëm të Trupave Mbrojtëse të Kosovës, si oficerë për informim publik dhe më pas në Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës. (Ali Uka)

ZEQIRI Fahri (1941-). Biolog, profesor universiteti. Lindi në Pejë, ku kreu shkollën fillore dhe të mesme. Studimet i përfundoi në katedrën e biologjisë të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës (1966). Studimet pasuniversitare dhe tezën e disertacionit të doktoratës i mbrojti në Universitetin e Zagrebit. Një kohë punoi mësime në shkollën fillore dhe të mesme në Pejë (1966), më pastaj zgjidhet asistent në departamentin e biologjisë të Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore (FSHMN) të

Universitetit të Prishtinës, ku mori titullin profesor ordinar. Ishte dekan në FSHMN. Është autor dhe përkthyes i teksteve shkollore dhe universitare. Publikoi punime shkencore dhe mbajti kumtesa në tubimet shkencore brenda dhe jashtë vendit. Ka bërë hulumtime në fushën e aktivitetit të enzimeve hidrolitike dhe oksidative të gjedhit dhe fetusit të tij. Për qëllime studimore ka qëndruar një vit në “Purdue University”, në Shkollën e Veterinarisë Mjekësore, në SHBA. Që nga vitet nëntëdhjetë jeton në Helsiniki, Finlandë, ku punoi një kohë në Institutin e Shkencave Biologjike. (Fetah Halili)

ZEQIRI Hakif (1957-). Inxhinier i makinerisë, profesor universiteti. Lindi në Kaçanoll të Mitrovicës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, të mesmen në Mitrovicë. Studimet e rregullta, studimet pasuniversitare dhe të doktoraturës i kreu në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike të Universitetit të Prishtinës (UP). Një kohë punoi në Shkollën e Mesme Teknike në Mitrovicë (1983), më pas u zgjodh asistent në Fakultetin e Xehetarisë dhe të Metalurgjisë dhe në Shkollën e Lartë Teknike të UP-së (1996). Në vitet vijuese avancohet në të gjithë titujt universitarë, përfshirë titullin profesor i rregullt (2013). Si autor dhe bashkautor publikoi një sërë punimesh shkencore në revista vendore dhe ndërkombëtare. Ndoqi disa trajnime me rëndësi për mësimdhënie dhe revidime të projekteve nga lëmi i inxhinierisë mekanike. Ushtri detyra me përgjegjësi dhe funksione drejtuese në Shkollën e Lartë Teknike, në Fakultetin e Shkencave Teknike të Aplikuara dhe në UP. Ishte dekan i Fakultetit të Shkencave të Aplikuara të UP-së dhe i Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike të Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë. (Avni Terziqi)

ZEQIRI Izet (1970-). Inxhinier i xehetarisë, profesor universiteti. Lindi në Kaçanoll, komuna e Mitrovicës. Kreu studimet në Fakultetin e Xehetarisë dhe të Metalurgjisë të Universitetit të Prishtinës (UP) (1994), ato pasuniversitare i mbaroi në Tiranë, ku mbrojti edhe tezën e disertacionit të doktoratës (2004). Në fillim punoi në Shkollën e Mesme Teknike në Mitrovicë dhe më pas (1996) kaloi në Fakultetin e Xehetarisë dhe të Metalurgjisë. Në periudhën 2003-2011 ishte angazhuar në Shkollën e Lartë Teknike, ndërsa nga viti 2014 mban ligjërata



IZET ZEQIRI

autor dhe bashkautor i teksteve universitare dhe i disa dispensave (“Metodat matematikore në inxhinieri” etj.). Ushtri detyra dhe funksione drejtuese në Fakultetin e Gjeoshkencave dhe të Teknologjisë, përfshirë edhe postin e dekanit (2009-2013) dhe më pas prorektor në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë. (Avni Terziqi)

ZEQIRI-NUSHI Dafina (1984). Kompozitore, mësimdhënëse. Lindi në Prishtinë, ku kreu Shkollën e Mesme të Muzikës dhe studimet në degën e kompozimit në Fakultetin e Arteve (2007). U magjistrua (2008) në Fakultetin e Muzikës në Shkup. Kompozoi: “Odiseja”, për kor të përzier (2008); Muzikë funebër, për piano (2007), Variacione me temë të Himnit kombëtar, piano (2012); “Kur vjen”, për mezosoprano e piano (2002); “O Bylbyl i mjerë” për tenor e piano (2008); solistike-instrumentale: Sonatë (2002) dhe “Atmospheres” për flaut e piano (2002), “Aerodinamik” për trombon e piano (2003), “Dissapear” për violë (2011); “Telegoni” për kuartet harqesh (2004), “Variacioni per arthi” (2004); Koncert për violonçel e orkestër (2007); Momento, për violinë e orkestër (2010) etj. Veprat e saj janë ekzekutuar në koncerte, festivale: në Kosovë, Shqipëri, Maqedoni, Itali, Hungari, Zvicër, Austri, Angli, Danimarkë, SHBA etj. Është fituese e çmimeve: Theodore Front Prize, SHBA (2009); vendi III në 4th Pre-Art Composers Competition në Zvicër (2008); vendi II në “Shopen Piano Fest”, konkursi për vepër pianistike (2012); “Composer’s Voice concert”, Nju-Jork (2012); Concert “The 4th Annual Trajetoria Brasileira” Nju-Jork (2014). Është themeluese dhe kryetare e organizatës Gratë kosovare në muzikë “Neo Musica”, anëtare e Aleancës Ndërkombëtare të Grave në Muzikë. Është asistente e angazhuar për harmoni dhe polifoni në Fakultetin e Arteve në Prishtinë. (Kristina Palokaj-Përkola)

ZGJEDHJET E PËRGJITHSHME PËR KUVENDIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS.

Në periudhën e pasluftës nga viti 2001 deri në vitin 2014, janë mbajtur pesë cikle të rregullta



PAMJE NGA ZGJEDHJET E PËRGJITHSHME NË KOSOVË

e të jashtëzakonshme zgjedhore. Zgjedhjet e para të përgjithshme janë mbajtur në vitin 2001, të dytat në vitin 2004, të tretat në vitin 2007, të katërtat më 2010 dhe të pestat më 2014. Zgjedhjet e vitit 2001 ishin zgjedhjet e para parlamentare në Kosovën e pasluftës. Ato u mbajtën më 17 nëntor të vitit 2001, në bazë të Kornizës Kushtetuese (2001) dhe të Rregullores së UNMIK-ut (2001/33), me organizim të OSBE-së. Në këto zgjedhje garuan 25 subjekte politike, koalicionë, kandidatë të pavarur dhe iniciativa qytetare. Edhe minoriteti serb mori pjesë në këto zgjedhje, me koalicionin e tyre "Kthimi". Nga 1,250,000 votues, morën pjesë 804,000 ose 64.30%. Në zgjedhje u votua vetëm për subjektet politike të certifikuara, ndërsa listat e votimit ishin të mbyllura. Zgjedhjet vijuese u mbajtën më 23 tetor 2004, përsëri sipas Rregullores së UNMIK-ut (2004/9 dhe 2004/11), ndërsa u organizuan në bashkëveprim të institucioneve të Kosovës dhe të OSBE-së. Sistemi i zgjedhjeve ishte proporcional dhe me lista të mbyllura, në zgjedhje garuan 33 subjekte politike, koalicionë, kandidatë të pavarur dhe iniciativa qytetare. Të drejtën e votës në këto zgjedhje e shfrytëzuan 695,000 votues ose 53.57%. Zgjedhjet e radhës u mbajtën më 17 nëntor 2007 dhe u votua për deputetë në Kuvendin e Kosovës, për kuvendet komunale dhe për kryetarët e komunave. Listat partiake ishin të hapura dhe kishte mundësi të votoheshin deri në 10 kandidatë nga lista e kandidatëve të një subjekti politik. Numri i votuesve në këto

zgjedhje ishte 1,454,000, ndërsa pjesëmarrja e votuesve ishte 40.10%. Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës u zhvilluan për një zonë elektorale, ndërsa ato për kuvendet komunale dhe për kryetarët e komunave u zhvilluan në 30 zona elektorale. Këto zgjedhje u vëzhguan nga 27, 000 vëzhgues vendorë e ndërkombëtarë. Ndërsa, zgjedhjet e vitit 2010 (u mbajtën më 12 dhjetor) ishin zgjedhje të parakohshme, që pasuan si rrjedhojë e prishjes së koalicionit qeverisës PDK-LDK, me tërheqjen e LDK-së. Në këto zgjedhje garuan 25 parti politike, 1 koalicion dhe 3 iniciativa qytetare, numri i votuesve të regjistruar ishte 1,636,000, ndërsa morën pjesë 779,000 votues ose 47.80%. Lidhur me këto zgjedhje, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) deklaroi se procesi elektoral u karakterizua me keqpërdorime të llojeve të ndryshme. Për rrjedhojë, u anuluan votimet në 21 qendra votimi, në 5 komuna. Për shkak të ankesave, KQZ-ja vendosi të bënte rinumërimin e votave në 40% të vendvotimeve në tërë territorin e Republikës. Dhe zgjedhjet e pesta me radhë, ato të vitit 2014, ishin përsëri zgjedhje të parakohshme. Ato u mbajtën më 8 qershor 2014 dhe u zhvilluan sipas standardeve të pranuar ndërkombëtare. Në këto zgjedhje morën pjesë edhe përfaqësuesit e 4 komunave të veriut të vendit, pra gjithsej 38 komuna të Kosovës me 1,782,000 votues dhe 2,000 kandidatë të subjekteve më të ndryshme politike. Në garën elektorale morën pjesë 19 parti politike, 7 nisma qytetare, 4 koalicionë dhe një 1 kandidat i pavarur. Pjesëmarrja e votuesve në këto zgjedhje ishte 43.16%. (Mazllum Baraliu)

ZGJEDHJET E VITIT 1920 NË KOSOVË.

Zgjedhje komunale dhe parlamentare të mbajtura nga Mbretëria Serbe-Kroate-Slllovene, ku ishte përfshirë edhe Kosova pas vitit 1913. Më 22 gusht 1920 u mbajtën zgjedhjet komunale, ndërsa në nëntor të po atij viti u mbajtën ato parlamentare. Zgjedhjet nuk ishin demokratike dhe u shoqëruan me dhunë ndaj shqiptarëve dhe kundërshtarëve të pushtetit. Kjo bëri që nga 55 komuna të Qarkut të Kosovës, zgjedhjet komunale dështuan në 28 komuna, ndërsa në 7 komuna fituesit u deklaruan neutralë. Fitues deklaroheshin gjithnjë radikalët serbë, ndërsa çdo rezultat tjetër heshtej. Në këto rrethana u konstituua Asambleja Kushtetuese, e cila më 1921 miratoi

të të ashtuquajturën Kushtetutë të Vidovdanit, me të cilën legjitimitet pushteti monarkik dhe unitarizmi. Çështjet nacionale sociale mbetën të pazgjidhura. Shqiptarët në këto zgjedhje u përfaqësuan me organizatën "Xhemijeti" (Bashkimi), e cila mori tri vende në parlament. Lideri i radikalëve serbë, Nikolla Pashqi, arriti të bënte qeverinë me mbështetjen e minoritetit gjerman dhe të shqiptarëve të "Xhemijetit", por nuk mbajti asnjë nga premtimet. (Izber Hoti)

ZGJEDHJET LOKALE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS. Nga viti 2002, në Kosovë janë mbajtur disa palë zgjedhje lokale. Zgjedhjet e para për qeverisjen lokale në Kosovë janë mbajtur më 28 tetor 2000. Numri i votuesve në ato zgjedhje ishte 913,179, me pjesëmarrje prej 79%, që njëherësh ishte edhe pjesëmarrja më e lartë e qytetarëve të Kosovës në një proces zgjedhor. Në këto zgjedhje është votuar sipas një sistemi të votimit të hapur, për një kandidat të vetëm. Votimi është zhvilluar në 30 komuna në mbarë Kosovën, në të cilat u zgjodhën 869 këshilltarë komunalë. Në tri komunat më shumicë serbe zyrtarët u emëruan nga kreu i administratës së OKB-së. Mandati i qeverisjeve lokale ishte vetëm dy vjet. U votua në 1,464 vendvotime dhe pati 380 qendra votuese, ndërsa zgjedhjet u ndoqën nga 13,976 vëzhgues. Zgjedhjet lokale të vitit 2002 ishin zgjedhjet e dyta të qeverisjes lokale në Kosovë. Ato u mbajtën më 26 tetor 2002., numri i votuesve ishte 1,320,481, ndërsa pjesëmarrja në votime 54%. Këto zgjedhje u organizuan sipas sistemit me lista të mbyllura. Këto zgjedhje lokale u organizuan në 30 komuna të Kosovës. Zgjedhjet lokale të radhës u mbajtën më 23 tetor 2004, bashkë me zgjedhjet parlamentare, ndërsa zgjedhjet lokale të vitit 2007 ishin të fundit që u mbajtën para shpalljes së pavarësisë së vendit. Në këto zgjedhje për herë të parë u vendos që pragu zgjedhor të jetë 5%. Zgjedhjet u organizuan në 30 komuna të Kosovës, ndërsa administrata e OKB-së emëroi kuvendet në pesë komuna ku jetonin me shumicë pjesëtarët e komunitetit serb. Votimi për këto zgjedhje u zhvillua me lista të hapura. Raundi i dytë në këto zgjedhje për kryetarët e komunave u organizua më 8 dhjetor të vitit 2007. Ndërkaq, zgjedhjet lokale të vitit 2009 ishin zgjedhjet e para lokale të organizuara nga institucionet e Kosovës dhe në bazë të ligjit për zgjedhjet e përgjithshme dhe për zgjedhjet lokale në

Kosovë, që janë realizuar pas shpalljes së Pavarësisë së vendit. Këto zgjedhje u mbajtën më 15 nëntor 2009, pjesëmarrja në to ishte 45.36% apo gjithsej 709,362 votues. Më 13 dhjetor ishte raundi i dytë i votimit, në të cilin u votua në 21 komuna të Kosovës. Zgjedhjet lokale të radhës u mbajtën më 3 nëntor të vitit 2013 në të cilat morën pjesë edhe votuesit e minoritetit serb të katër komunave veriore të Kosovës. Këto zgjedhje rezultuan me ndryshime të pushteteve lokale, pothuajse në gjithë vendin. Zgjedhjet lokale të vitit 2013 kanë shënuar një progres në mbarëvajtjen e procesit zgjedhor dhe transformimin e pushtetit. Në këto zgjedhje pjesëmarrja e qytetarëve ishte 46.31%. (Mazllum Baraliju)

ZGJEDHJET NË KOSOVË (1992-1998). Janë zgjedhjet e mbajtura gjatë kohës së pushtimit serb të Kosovës. Gjatë kësaj periudhë u mbajtën dy palë zgjedhje, në vitin 1992 dhe në vitin 1998, kryesisht të organizuara nga Lidhja Demokratike e Kosovës. Zgjedhjet e vitit 1992, ishin zgjedhjet e para pluraliste parlamentare dhe presidenciale në Kosovë. U mbajtën më 24 maj 1992, si pjesë e lëvizjes gjithëpërfshirëse të shqiptarëve për liri dhe pavarësi. Ndonëse të përgatitura dhe të realizuara në rrethana të rënda të represionit shtetëror serb, pjesëmarrja e popullsisë në to ishte e lartë. Shumicën dërrmuese të vendeve në Kuvendin e Kosovës i fitoi Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK). Kuvendi i dalë nga këto zgjedhje nuk arriti të mblidhej, sepse u pengua në vazhdimësi nga pushteti serb. Ndërkaq, në vitin 1998 u mbajtën zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale në Kosovë. Shpallja e zgjedhjeve u bë më 23 dhjetor të vitit 1997, ndërsa ato u mbajtën më 22 mars të vitit 1998. Sipas të dhënave të Komisionit të Zgjedhjeve, zgjedhjet u mbajtën në 29 zona-njësi zgjedhore, në të cilat u votua për zgjedhjen e presidentit të vendit dhe të 130 deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Kryetar i Komisionit të Zgjedhjeve të 22 marsit 1998 ishte gjyqtari Tadej Rodiqi. Me këto zgjedhje, ndonëse të mbajtura në kushte të rënda, konsiderohej se do të mund të forcohej rendi demokratik në Kosovë dhe do të avancohej legjitimiteti i udhëheqjes dhe i institucioneve të Kosovës. Partia Parlamentare e Kosovës, së bashku me UNIKOMB-in, Partinë Social-demokrate, Partinë Liberale Shqiptare, pastaj Këshilli Koordinues i degëve të LDK-së në

Prishtinë, Unionin e Pavarur të Studentëve, Shoqatën e të Burgosurve Politikë dhe Forumin e Intelktualëve Shqiptarë vendosën që t'i bojkotonin këto zgjedhje. (Mazllum Baralio)

ZIBERI Miftar (1949-). Mësimdhënës universitar, trajner i volejbollit. Lindi në Tetovë të Maqedonisë, ku kreu shkollimin fillor dhe të mesëm. Kreu Fakultetin e Kulturës Fizike në Beograd. Në vitin 1974, së bashku me një grup sportdashësish, themeloi KV "Shkëndija" në Tetovë. U emërua trajner i parë i skuadrës dhe brenda dy stinorëve u bë anëtar i Ligës së Parë republikane, ndërsa më pas edhe i ligës së dytë federative - grupi i jugut. Gjatë viteve 1981-1990 u shpërngul nga Maqedonia dhe në Kosovë ndihmoi disa klube, sidomos KV "Taftosoni" të Gjilanit. Në vitin 1991 në Tetovë themeloi për të dytën herë KV "Shkëndija" dhe u bë trajner i kombëtares së Maqedonisë deri në vitin 1996. Në vitin 2003 në Bratisllavë mori licencën e trajnerit të kategorisë së parë të FVB-së. Ndërkohë mbrojti tezën e disertacionit në Universitetin e Tiranës në fushën e volejbollit dhe, pas themelimit të Fakultetit të Edukimit Fizik dhe të Sporteve në kuadër të Universitetit të Tetovës, ligjëroi lëndën e volejbollit, ndërsa nga viti 2000 e deri më 2007 në Fakultetin e Kulturës Fizike të Universitetit të Prishtinës mbajti po këtë lëndë. Ka botuar një numër punimesh shkencore nga fusha e sportit. (Xhavit Kajtazi)


ZIROJEVIQ (Zirojević) Olga (1934 -). Historiane, osmanologe serbe nga Beogradi. U diplomua për histori në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Beogradit, ndërkaq studimet pasuniversitare i kreu në katedrën e historisë dhe në katedrën e orientalistikës të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Sarajevës (1958-1960). Për vite të tëra zhvilloi hulumtime sistematike në arkivin e qeverisë turke në Stamboll. Është autore e disa monografive dhe e shumë artikujve shkencorë të botuar kryesisht në revista shkencore të vendeve ballkanike. Një pjesë e opusit të saj shkencor bën fjalë edhe për historinë e Kosovës dhe të hapësirave të tjera shqiptare. Vepra e saj "Kishat dhe manastiret në territorin e Patrikanës së Pejës deri në vitin 1683" është një kontribut i rëndësishëm për historinë e Kishës Ortodokse në Ballkan. Studimi i saj shtrihet edhe para vendosjes së sundimit osman dhe përfshin një territor më të

gjerë se ai i Kosovës së sotme. (Gazmend Rizaj, Dritan Egro)

ZLATANOVIQ (Zlatanović) Radoslav (1936-). Shkrimtar i letërsisë serbe nga Kosova, gazetar. Lindi në Muçivërc, afër Kamenicës. Mbaroi shkollimin fillor në Bujanoc, Shkollën Normale në Prizren, ndërsa studimet për gjuhë dhe letërsi angleze në Universitetin e Prishtinës. Ishte gazetar dhe redaktor në gazetën "Jedinstvo" në Prishtinë dhe redaktor i poezisë në Shtëpinë Botuese "Jedinstvo" që nga themelimi i saj. Përveç poezisë, botoi edhe tregime. Përkthen nga gjuha angleze dhe shqipe. Botoi përmbledhjet e poezive: "Prekja e verës" (1962) "Zhvendosja e gjumit" (1970), "Ndriçimet e hidhura" (1974), "Kremta e kënduar" (1978), "Britma në kafshë" (1984), "Darka e Graçanicës" (1995). Nga shqipja përktheu antologjinë e poezisë së Kosovës (me Ibrahim Rugovën dhe Ethem Bajmakun) "Lulet në ballkon" (1982). (Ismet Marković)

ZLLAKUQANI. Fshat në komunën e Klinës, 7 km në verilindje të saj. Shtrihet në lartësi mbidetare 450 m. Në vitin 2011 kishte 660 banorë, ndaj 518 banorëve në vitin 1948. Është vendbanim i tipit të grumbulluar. Popullsia merret kryesisht me bujqësi dhe blegtori ekstensive, tregti etj. Ka shkollën 9-vjeçare, zyrën e ofiqarisë, stacionin shëndetësor, disa njësi tregtare, etj. Është bashkësi lokale, në të cilën gravitojnë vendbanimet Zllakuqan, Radulloç, Leskoc, Ranoc dhe Berkovë. (Ferim Gashi)

ZLLATKU Rexhep (1939-). Gazetar, shkrimtar. Lindi në Dibër. Filloren e mbaroi në vendlindje, ndërsa gjimnazin në Prishtinë. Studimet për drejtësi i mbaroi në Universite-



REXHEP ZLLATKU

tin e Shkupit. Më 1960 nis punën si gazetar në gazetën "Flaka e vëllazërimit". Ndërkohë u bë korrespondent nga Shkupi i gazetës "Rilindja". Pas disa vjetësh sërish u kthye në "Flakën e vëllazërimit", si kryeredaktor i saj, deri në vitin 1990. Përveç lajmeve e raporteve për ngjarje dite, shkroi reportazhe dhe udhëpërshkrime. Përveç në gazetën "Rilindja" dhe "Flaka e

vëllazërimet”, ka botuar shkrime edhe në gazetë e tjera në gjuhën shqipe në Prishtinë. Pas pavarësisë së Maqedonisë ishte ministër i Informimit. Përveç veprave publicistike, është autor edhe i disa veprave letrare: “Droja e kadiut” (roman, 1994), “Plagoma” (roman, 1993), “Me arbëreshët” (udhëpërshkrime, 1996), “Error” (reportazhe), “Trishtimi i miliongonave”, “Shekujt e ngatërruar”, “Magjia e Ballkanit”, “Kanunet s’rrojnë sa malet” etj. (Zenun Çelaj)

ZOGAJ Agim (1954-). Profesor universitar. Lindi në Turjakë të Malishevës. Shkollën fillore dhe të mesme i mbaroi në Prishtinë, ndërsa studimet themelore në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës (UP), në katedrën filozofi-sociologji. Studimet pasuniversitare i mbaroi për histori po në këtë fakultet, ndërsa më 2002 mbrojti temën e disertacionit të doktoratës me titull: “Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave 1945-1948”. Si student ishte kryeredaktor i gazetës së studentëve “Bota e re”, i revistës shkencore “Dituria”, ndërsa më vonë edhe i javores politike “Zëri”. Përveç si mësimdhënës, kreu edhe detyra të tjera në Fakultetin Filozofik dhe në UP. Është autor i disa librave, ndër të cilat: “Procesi i Prizrenit”, “Kritikë historiografike bashkëkohore, “Paqja e ftohtë”, “Dëshmi për Kosovën 1989-1991”, “Fuqia e ideve”, “Ndërhyrja e PKJ-së në Shqipëri gjatë Luftës Dytë Botërore”, “Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave dhe çështja e Kosovës 1945-1948” etj. (Alfred Marleku)

ZOGAJ Habib (1957-). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), gazetar. Lindi në Turjakë të Malishevës. Një kohë punoi në arsim në fshatin Lumnishtë e Ponorc, më pas gazetar në Radio-Gjakovë, si dhe bashkëpunëtor i Radio-Prishtinës dhe i gazetës “Rilindja”. Në periudhën 1990-1993 udhëhoqi Lidhjen e Arsimitarëve Shqiptarë për komunën e Malishevës. Në vitin 1998 u inkuadrua në radhët e UÇK-së. Ishte komandant për moral dhe politikë në Brigadën 122 të Zonës Operative të Pashtrikut (1998), pastaj zëdhënës i UÇK-së në Dragobil, reporter lufte i Radios “Kosova e lirë” dhe i agjencisë së lajmeve “Kosovapress”. Pas luftës një kohë punoi si gazetar në Radion “Kosova e lirë”, më pas në gazetën “Kosova sot” dhe televizionin “Opinion”. Nga viti 2009 udhëheq Radion “Malisheva”. (Ali Uka)

ZOGAJ Rexhep (1935-2010). Shkrimtar, gazetar aktivist shoqëror-politik i peridhës së autonomisë së Kosovës. Lindi në Turjakë, komuna e Rahovecit, ku kreu katër klasat e fillores ndërsa semimaturën dhe gjimnazin i kreu në Prishtinë. Studimet universitare për gjuhë dhe letërsi shqipe i kreu në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Beogradit. Një kohë punoi si gazetar, redaktor dhe kryeredaktor i gazetës “Rilindja” dhe më pas drejtor i përgjithshëm i ndërmarrjes “Rilindja”. Gjatë viteve ’70 dhe të ’80 ishte i angazhuar në forume të larta partiake e shtetërore të Kosovës. Me shkrime letrare është marrë që në rininë e hershme. Ka shkruar kryesisht prozë, por është marrë edhe me publicistikë politike e sociologjike. Është autor i këtyre veprave: “Kurgja e jashtëzakonshme” (1961), “Dhuna” (1977), “Kohë heshtjeje e vetmie” (1986), “E diela e Ukshin Currit” (1990), “Rrethi i dhunës” (1994), “Vrasja e azilantit” (1996), “Magjia” (1998), “Një verë tjetër” (1999), “Mëkati i Djellës” (2001), “Ankthi i fundshekullit” (2003), “Zana misterioze” (2005), “Procesi K.” (2007). Në vitin 2007 Ministria e Kulturës e Kosovës ia botoi veprat e plota në disa vëllime. (Munish Hyseni)

ZOGAJ Skënder (1950-). Gazetar, shkrimtar. Lindi në Lladrovç të Malishevës. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Prizren, ndërsa studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Universitetin e Prishtinës. Në fillim punoi mësimdhënës i gjuhës shqipe në gjimnazin e Malishevës (1971-1974) dhe më pas gazetar dhe redaktor në gazetën e studentëve “Bota e re” (1974-1978). Në vitin 1978 nis punë në gazetën e përditshme “Rilindja”, gazetar në rubrikën e kulturës, ku ka ndjekur zhvillimet në teatër, radiotelevizion, amatorizëm etj. Nga viti 1995 punoi në redaksinë e gazetës “Rilindja” në Tiranë, ku për disa vjet ishte redaktor i shtojcës për fëmijë. Gjatë viteve ’90 u përfshi në zhvillimet politike të kohës: ishte kryetar i degës së Lidhjes Demokratike të Kosovës për Fushë-Kosovë dhe, pas luftës së vitit 1999, në zgjedhjet e para lokale, kryetar i komunës së Fushë-Kosovës. Është autor i disa vëllimeve me poezi për fëmijë dhe të rritur: “Zogu i ekspozitës” (1983), “Merrmë vëlla përdore” (1994), “Ora e qoftëlargut” (1996), “Adresa e dallëndyshes” (1999), “Puthjet e puhisë” (2007), pastaj i monografisë “Jusuf Uka Bregu, luftëtar i Ballit Kombëtar” etj. (2002). (Behlul Jashari)

ZOGJANI Avni (1970-). Gazetar. Lindi në Graboc të Fushë-Kosovës. Shkollën fillore e kreu në fshatin e lindjes, të mesmen në Prishtinë, ndërsa studimet për gazetari në Prishtinë. Bëri specializime dhe ngritje profesionale në SHBA dhe në Britani të Madhe. Në gazetën “Koha ditore” punoi si gazetar që nga viti 1997. Ndoqi zhvillimet nga zonat e luftës së Kosovës, ndërsa raportet u publikuan edhe në mediet ndërkombëtare. Pas luftës po në gazetën “Koha ditore” shkroi për zhvillimet në arsim dhe gjyqësi. Ishte njëri ndër themeluesit e organizatës joqeveritare “Çohu!” (2006), ku për disa vjet bëri hulumtime për korrupsionin në institucionet e vendit. Një kohë të shkurtër u përfshi në politikë, në Lëvizjen “Vetëvendosje”, prej nga u largua në vitin 2014. (Gazmend Sylja)

ZOGJANI Behar (1959-). Gazetar. Lindi në Harilaq të Fushë-Kosovës. Arsimimin bazë e mori në vendlindje, ndërsa në Prishtinë kreu Fakultetin Juridik. Disa vjet punoi gazetar në “Rilindje”, pas luftës ishte analist i medieeve në Misionin e Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), më pas gazetar, producent, organizator, përkthyes në disa medie ndërkombëtare. Punoi edhe si këshilltar politik, zëdhënës dhe ligjërues për lëndën e etikës së gazetarisë, pastaj bartës i projekteve nga fusha të ndryshme të organizatave rajonale dhe ndërkombëtare në Kosovë. Nga viti 2008 punon si këshilltar në Ambasadën e Republikës së Çekisë në Prishtinë. Botoi librin dokumentar “Përballuesi i dallgëve” (2006), pastaj doracakët “Komunikimi me publikun” dhe “Domosdoshmëria e komunikimit me publikun” (2013), si dhe ribotimin e këtij të fundit me alfabetin e Brajtit, për nevoja të studentëve të verbër (2015). (Ibrahim Berisha)

ZOGJANI Hysen (1957-1998). Lindi në Harilaq të Fushë-Kosovës. Pas shkollës së mesme ekonomike në Prishtinë, kreu Shkollën e Lartë Komerciale në Pejë. Punoi në ndërmarrjen “Hidroteknika” në Prishtinë. Ishte aktivist i lëvizjes ilegale për çlirimin e Kosovës, bashkëpunëtor i ngushtë me disa nga themeluesit e UÇK-së. U angazhua në punë logjistike, veçmas në bartjen e armatimit nga Shqipëria në Kosovë dhe brenda Kosovës, nga një bazë në tjetrën. Më 22 qershor 1998 u kidnapua në Prishtinë dhe që nga ajo ditë nuk u gjet asnjë gjurmë e tij. (Ruzhdi Jashari)

ZOGJANI Hilmi (1959-). Gazetar, diplomat. Lindi në Harilaq të Fushë-Kosovës. Shkollimin e kreu në vendlindje dhe në Prishtinë. Mbaroi studimet për gjuhë dhe letërsi angleze në Universitetin e Prishtinës. Punoi arsimtar i gjuhës angleze dhe bashkëpunëtor i programit të dramës dhe i filmit në Radio Televizionin e Prishtinës (RTP) deri në mbyllje nga pushteti serb (korrik 1990). Në periudhën 1992-1999 punoi në Qendrën për Informim të Kosovës (QIK), si gazetar dhe redaktor i informatorit ditor në gjuhën angleze dhe i gazetës “Informatori i mbrëmjes”. Pas vitit 1999 ka punuar në zyrën e Kosovës në Londër, më pas në Radiotelevizioni-21, redaktor i programit në gjuhën angleze, si dhe në misionin e OSBE-së në Kosovë, si përkthyes dhe analist i medieeve. Në vitin 2008 u emërua sekretar i parë i Ambasadës së Kosovës në Austri dhe më pas ambasador në Pragë. Punon në bibliotekën e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. (Ibrahim Berisha)

ZOGNOS Mehmet Pashë (1403-1466). Njëri ndër komandantët dhe pushtetarët e dalluar të Perandorisë Osmane. Ndonëse burimet osmane nuk e përmendin origjinën e tij, shumica e autorëve europianë e konsiderojnë të origjinës shqiptare. Sipas disa osmanologëve, Zognos Mehmet Pasha ishte nga Vushtrria, i cili u mor devërshtim, u islamizua dhe u edukua si jeniçer. Duke qenë besnik ndaj sulltanit, Mehmet Pasha u bë edhe dhëndër i sulltan Muratit II (1403-1451). Zognos Mehmet Pasha ishte kujdestar-edukator i sulltan Mehmet II dhe i Gjergj Kastriotit-Skënderbeut. Si vezir i dytë, së bashku me shqiptarin tjetër, admiralin e flotës Hamza Beun, ishte ndër figurat qendrore në rrethimin dhe pushtimit e Konstandinopojës (1453). Minatorët e Novobërdës, të angazhuar për hapjen e tuneleve nëntokësore, ishin nën komandën e Zognos Pashës. Trupat e para që arritën te fortifikatat e Konstandinopojës ishin gjithashtu të Zognos Pashës, andaj sulltan Mehmeti II fortifikatën lindore të Rumeli Hararit e emëroi sipas këtij pashai. Një ditë pas rënies së Konstandinopojës (29 maj 1453), Zognos Pasha u emërua vezir i parë (sadrizem), post që e mbajti deri në vitin 1456. Më vonë u caktua vali i Thesalisë, më 1461 pushtoi Perandorinë e Trapezuntit (Trabzonit), më 1463 u emërua sanxhakbej

i Galibolit dhe të njëjtin vit iu besua posti i admiralit të flotës osmane. Në prag të vdekjes u emërua sanxhakbej i Balëkesirit. (Gazmend Rizaj)

ZOLTA Georg Renatus (Solta) (1919-2005). Ballkanolog, indoeuropianist austriak. Lindi në Vjenë, mësoi në Linc, ndërsa studimet i vijoi në Universitetin e Vjenës. Studioi gjuhësi krahasuese indoeuropiane, filologji dhe romanistikë klasike. Punoi në Institutin e Indogjermanistikës të Universitetit të Vjenës, ku ligjëroi gjuhësi indoeuropiane e ballkanistikë. Ishte anëtar korrespondent i Akademisë Austriake të Shkencave. Njihet si specialist për armenishten, me latinishten etj. Në fushën e ballkanistikës ka lënë veprën “Hyrje në gjuhësinë ballkanike me vështrim të veçantë për substratin e latinitetit ballkanik” (Einführung in die Balkanlinguistik mit besonderer Berücksichtigung des Substrats und des Balkanlateinischen, 1980). Në të është marrë dhe me shqipen. Sipas tij shqipja ka luajtur rol vendimtar në formimin e ballkanizmave. Kritikonte tezat e ndikimit grek dhe latin në përfitimin e ballkanizmave. Në profilin e tij shkencor pati ndikim të madh albanologu N. Jokli. (Shpëtim Elezi)

ZONA NEUTRALE E JUNIKUT (1921-1923). Zonë e demarkacionit midis Shqipërisë dhe Mbretërisë Serbe-Kroate-Slllovene. Shtrihet nga Qafa e Morinës deri në lumin Bistricë dhe në grykën e Deçanit. Zonën e përbënin 18 fshatra, kryesisht të Rekës: Juniku, Mulliqi, Ponosheci, Batusha, Brovina, Shishmani, Babajt e Bokës, Popoci, Koshara, Vokshi, Pobergja, Dranoci, Lloçani etj. U formua në dhjetor të vitit 1921, me vendim të Konferencës së Ambasadorëve në Paris dhe zgjati deri në shkurt të vitit 1923. Shërbeu si ndalje e konflikteve mes dy shteteve, por u bë bazë kryesore e çetave çlirimtare të Kosovës dhe të forcave kryengritëse të Malësisë së Veriut, që mbështeteshin dhe bashkëpunonin edhe me opozitën në Tiranë. Aty koordinoheshin veprimet rreth strategjive politike dhe ushtarake të personaliteteve të shquara të kohës nga të dy anët e kufirit, si: Hasan Prishtina, Bajram Curri, Azem Bejta, Nak Berisha, Ramë Binaku etj. Organet më të larta shtetërore të Mbretërisë Jugosllave i kushtuan vëmendje shkatërrimit të kësaj zone, sepse me zhdukjen e saj neutralizohej lëvizja kaçake dhe paqësohej Kosova. Në vitin

1922, në Zonën Neutrale të Junikut numri i të arratisurve arriti në rreth 2,000 vetë. Më 17 qershor 1922 trupat e ushtrisë dhe të xhandarmërisë jugosllave filluan operacion spastrimi të Zonës. Kryengritësit kosovarë dhe malësorët, për të ruajtur popullsinë civile, iu shmangën luftës frontale. Megjithatë, ekspedita ushtarake jugosllave, me qëllim të likuidimit të prijësve kryengritës dështoi. Po në këtë vit dëmet ndaj popullsisë shqiptare u shtuan, me vrasje, plaçkitje dhe djegie të fshatrave dhe shtëpive të kryengritësve. Në janar të vitit 1923, trupat e ushtrisë shqiptare, në ndjekje të forcave të Bajram Currit dhe të Hasan Prishtinës që kishin sulmuar Tropojën dhe Krumën, në ditët e para të janarit hynë në Junik. Pas ngjarjeve në Junik, forcat vullnetare të lëvizjes u tërhoqën në fshatra të tjera. Ushtria shqiptare hyri në Junik më 17 janar të vitit 1923, pas një rezistence të vogël, pa pësuar dëme. Çetat e Kosovës u larguan nga Juniku, disa në Malësi, të tjerat në territorin Mbretërisë Jugosllave dhe në drejtim të Rugovës. Më 30 janar të vitit 1923 komandanti i operacionit, major Prenk Jaku, kërkoi që ushtria shqiptare të mbetej së paku dy muaj në Zonën Neutrale të Junikut për të ndjekur krerët kryengritës të Kosovës. Pasi u largua ushtria shqiptare, bandat çetnike depërtuan nga lindja, ndërsa kryengritësit shqiptarë zbritën nga malet ku ishin tërhequr dhe u rikthyen në Junik. Kryengritësve iu bashkëngjiten një numër i popullsisë vendase dhe organizuan një rezistencë të fuqishme. Megjithatë, më 21 shkurt të vitit 1923, ushtria e Mbretërisë Jugosllave hyri në Zonën Neutrale të Junikut, duke bërë krime mbi popullsinë civile. Në një rrethanë të tillë, popullsia u detyrua të tërhiqej në Malësi, numri i të cilëve arrinte mbi 2,000 vetë. Më shuarjen e Zonës Neutrale të Junikut, lëvizja çlirimtare në Kosovë pësoi goditje të rëndë. (Luan Tetaj)

ZONA OPERATIVE E DRENICËS (ZOD). Strukturë organizative e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), e themeluar në maj të vitit 1998, që përfshinte rajonin e gjerë të Drenicës, në Kosovën Qendrore. Ishte zona e parë operative e UÇK-së, aty ku lindi UÇK-ja dhe filloi lufta çlirimtare e Kosovës. ZOD-i kufizohej me Zonën Operative të Shalës, të Pashtrikut dhe të Dukagjinit. Në këtë zonë u themelua Brigada 111 “Adem Jashari”, që ishte formacioni i parë dhe më i përgatitur i

UÇK-së. ZOD-i kishte katër brigada. Brigada e parë ishte Brigada 111 "Adem Jashari", e cila kishte mbi 100 ushtarë dhe komandohej nga Jahir Demaku. Kjo brigadë kishte edhe njësitin special të policisë ushtarake. Brigada e dytë ishte Brigada 112 "Arben Haliti", që komandohej nga Abedin Rexha, kurse pas vdekjes së tij nga Jetulla Geci. Kjo brigadë kishte mbi 1,000 ushtarë. Brigada e tretë ishte Brigada 113 "Mujë Krasniqi" me komandant Hysni Shabanin, që kishte mbi 1,000 ushtarë. Brigada e katërt ishte Brigada 114 "Fehmi Lladrovci", e cila kishte mbi 1,150 ushtarë, komandant i së cilës në fillim ishte Fehmi Lladrovci, më pas Ilaz Kodra dhe së fundi Nuredin Lushtaku. Në Zonën Operative të Drenicës ishte edhe shkolla ushtarake në Negroc për gradat e nivelit të lartë. Ndër betejat më të rëndësishme të zhvilluara në këtë zonë ishin: beteja e Prekazit, në Rezallë të Re (Klysyre), Beteja e Llapushnikut, e Çirezit, e Likoshanit etj. Në këtë zonë UÇK-ja e kishte të organizuar mirë shërbimin shëndetësor. Aty funksiononte spitali ushtarak, ku janë kryer edhe shumë ndërhyrje kirurgjike. Në qendrat e kësaj zone janë mbajtur takime të rëndësishme politike dhe diplomatike, të cilat kanë qenë të rëndësishme për mbarë zhvillimet historike të kësaj periudhe. (Mustafë Haziri)

ZONA OPERATIVE E DUKAGJINIT (ZOD)
Strukturë organizative territoriale e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), e cila përfshinte zonën e gjerë në Perëndim të Kosovës, të komunave: Gjakovë, Deçan, Pejë, Istog dhe një pjesë të komunës së Klinës. Aksionet e para guerile kundër forcave ushtarake-policore dhe paramilitare serbe në këtë zonë kanë filluar që nga viti 1991. Në fillimet e luftës frontale në Kosovë, Jabllanica, Glogjani dhe Smolica ishin tri qendrat kryesore të UÇK-së në Zonën Operative të Dukagjinit. Komandant i ZOD-it gjatë gjithë kohës së luftës ka qenë Ramush Haradinaj. ZOD-i ishte zonë e rëndësishme së veçantë për UÇK-në, sepse nëpër këtë zonë kalonin rrugët kryesore të furnizimit me armatim dhe municion qoftë nga Shqipëria, qoftë nga drejtimi i Malit të Zi. Për shkak të rëndësisë që kishte, Serbia përqendroi numrin më të madh të forcave në këtë zonë dhe ndërmoi ofensivat më të ashpra. Që nga fillimi i luftës frontale në betejën e 24 marsit 1998 në Glogjan dhe deri në mbarim të saj, në këtë zonë u zhvilluan beteja të pandërprera. Përveç

betejës së Glogjanit, gjatë vitit 1998 u zhvilluan beteja në Baballoç, Gramaçel, Deçan, Prilep, Carrabreg, Rastavicë, Smolicë, Morinë, Voksh, Junik, Loxhë, Jabllanicë etj. Në ZOD u formuan tetë brigada: Brigada 131 "Jusuf Gërvalla", me komandant Daut Haradinajn; Brigada 132 "Myrtë Zeneli" me komandant Maliq Ndrecajn; Brigada 133 "Adrian Krasniqi" me komandant Azem Veselin; Brigada 134 "Bedri Shala" me komandant Agron Ramën e më pas Ismet Ahmetin; Brigada 135 "Agim Zeneli" me komandant Lulzim Morinën; Brigada 136 "Rugova" me komandant Sali Lajçin e Florim Çelën; Brigada 137 "Gjakova" me komandant Agron Kryeziun e më pas Avdullah Babalinë; Brigada 138 "Agim Ramadani" me komandant Rustem Berishën. Zona kishte edhe njësitin për ndërhyrje të shpejta "Shqiponjat e Zeza", policinë ushtarake, batalionin gardist etj. Selia e komandës së ZOD-it fillimisht ishte në Glogjan, pastaj në Jabllanicë, Maznikë etj. Brigadat e ZOD-it zhvilluan beteja të shumta në zonat e tyre të përgjegjësisë: Brigada 131 "Jusuf Gërvalla" nga 17 dhjetori 1998-17 janar 1999 në vijën e frontit Glogjan-Ratish-Dashinoc-Lumbardh, pastaj në Pozhar (27 mars-2 prill 1999), për shpëtimin e të plagosurve (prill 1999), në Kodrat e Zhebelit (16 prill 1999) dhe beteja të tjera deri në çlirimin e vendit. Beteja të rëndësishme u zhvilluan edhe në zonën e përgjegjësisë të Brigadës 132 "Myrtë Zeneli" në Dashinoc, Gërgoc, Kralan, Buçan, Jabllanicë, Llugaxhi, Bardhaniq, Zhebel, Rakovinë etj., ndërsa në rajonin e përgjegjësisë të Brigadës 133 "Adrian Krasniqi" u zhvilluan beteja në Vrellë, Nabërgjan, Ruhot, Lutogllavë, Tërstenik, Trubuhovc, Radavc, Tomoc, etj. Brigada 134 "Bedri Shala" zhvilloi beteja në Smolicë, Morinë, Junik, Ponoshec, Dobrosh etj., pastaj në Ratish e Dashinoc, në Shishmon të Bokës, në Morinë etj. Ndërkaq, Brigada 135 "Agim Zeneli" zhvilloi betejën e Buçanit, të Kodrës së Kamenicës, të Jabllanicës e Llugaxhisë, të Kosuriqit, Vranocit, Çallapekut, betejat për çlirimin e qytetit të Pejës etj. Brigada 136 "Rugova" zhvilloi betejën për mbrojtjen e Shtupeçit të Madh (24 gusht 1998), në grykë të Rugovës (mars 1999), në Qafë të Hajles (më 18 e 19 prill 1999) etj. Beteja më e rëndësishme e Brigadës 137 "Gjakova" ishte beteja e Çabratit, e zhvilluar në qytetin e Gjakovës (maj 1999), ndërsa Brigada 138 "Agim Ramadani" nga 9 prilli 1999 deri në çlirimin e plotë të Kosovës

zhvilloi beteja te Rrasa e Koshares, në Bjeshkët e Junikut, te Rrasa e Zogut, në Koshare, në Qafë të Morinës etj. Në rajonin e përgjegjesisë të Zonës Operative të Dukagjinit kanë rënë dëshmorë 832 luftëtarë dhe eprorë të UÇK-së. (Fetnete Ramosaj)

ZONA OPERATIVE E KARADAKUT (ZOK). Strukturë organizative territoriale e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e cila përfshinte territorin e komunave: Gjilan, Kamenicë, Viti dhe Novobërdë. Në këtë zonë UÇK-ja ndërmoi aksione guerile, frontale dhe logjistike. Kontaktet e ZOK-ut me Shtabin e Përgjithshëm (SHP) të UÇK-së u vendosën në fillim të vitit 1998. Më 18 qershor 1998, Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së e emëroi Ahmet Isufin koordinator për organizimin e Nënzonës së Karadakut. Më pastaj u vendosën kontakte me Zonën Operative të Llapit. Datë e formimit të ZOK-ut merret 8 nëntori 1998, kur SHP i UÇK-së vendosi që nënzona të kthehej në zonë operative. ZOK-u kishte këtë strukturë udhëheqëse: komandant Ahmet Isufi, zëvendëskomandant Shemsi Syla, shef i shtabit Daut Ilazi, shef i sektorit të personelit Emin Krasniqi, shef i sektorit për informim Hanëmshahe Abdullahu, shef i sektorit për moral Lulzim Leci dhe shef i sektorit për logjistikë Basri Musmurati. Kjo zonë formoi këto brigada: Brigada 171 “Kadri Zeka” me komandant Sali Mustafën, Brigada 172 “Isa Kastrati” me komandant Shefki Beqirin dhe brigada 173 “Gursel dhe Bajram Sylejmani” me komandant Sali Nezirin. Më 15 dhe 16 prill 1999 u zhvillua beteja e Zhegocit. Në këtë betejë të Zonës Operative të Nerodimes, në luftime të drejtpërdrejta mori pjesë brigada 171 “Isa Kastrati” e Zonës Operative të Karadakut. Kjo betejë shënoi fillimin e luftës frontale me armikun në zonën e Karadakut. Në këtë betejë u vranë 22 luftëtarë dhe nga popullata civile u vranë 22 veta. Nga 18 deri me 22 prill 1999 në ZOK u zhvillua beteja e Marecit, në të cilën morën pjesë brigada 153 nga Zona Operative e Llapit, brigadat 171, 172, dhe 173 të ZOK-ut. Luftime të ashpra u zhvilluan në të gjitha frontet. Në betejën e Marecit ranë 27 luftëtarë, ndër ta edhe Heroi i Kosovës, Isa Kastrati. Nga ZOK ranë në beteja 82 dëshmorë. (Bedri Muhadri, Shemsi Syla)

ZONA OPERATIVE E LLAPIT (ZOLL). Strukturë organizative territoriale e Ushtrisë

Çlirimtare të Kosovës (UÇK), që përfshinte krahinën e Llapit në pjesën verilindore të Kosovës. Si hapësirë organizative e UÇK-së përfshinte katër qendra administrative komunale: Prishtinën, Podujevën, Fushë-Kosovën dhe Obiliqin. Lidhja e parë e celulave ushtarake që funksiononin në Llap me Shtabin Qendror të UÇK-së u realizua në fillim të dhjetorit të vitit 1995. Rënia e Zahir Pajazitit, me bashkëluftëtarët Hakif Zejnullahu e Edmond Hoxha ka qenë një goditje për UÇK-në në Llap. Bashkëluftëtarët e tyre u detyruan të kalonin në ilegalitet të thellë dhe të emigronin jashtë vendit. Riorganizimi i strukturave të UÇK-së u bë nga fundi i vitit 1997 dhe fillimi i vitit 1998. Aktivitetet e para publike luftarake të ZOLL-it filluan më 6 qershor 1998 në fshatin Zabërgjë të Shalës dhe vazhduan në fshatin Bajgorë nga 13 korriku 1998, ku bëhet rekrutimi, strukturimi, rreshtimi dhe stërvitjet e njëjse të para të kësaj zone. Më 18 korrik 1998 në takimin e strukturave drejtuese të ZOLL-it u emërua shtabi me komandant Rrustem Mustafën-Remin dhe me zëvendëskomandantët Kadri Kastratin dhe Nuredin Ibishin, si dhe me një numër udhëheqësish të sektorëve të ndryshëm. Pjesëtarët e UÇK-së në ZOLL ishin të rreshtuar në tri brigada: Brigada 151 “Zahir Pajaziti” e komanduar nga Idriz Shabani, Brigada 152 “Shaban Shala” e komanduar nga Nuredin Ibishi e Arif Muçolli dhe Brigada 153 “Hyzri Talla” e komanduar nga Sejdi Veseli dhe Adem Shehu. Në kuadër të Zonës vepronte edhe njësi gueril “BIA”, i komanduar nga Salih Mustafa. Në ZOLL u zhvilluan disa beteja, shumë luftime dhe operacione ushtarake, ndër të cilat veçojmë: betejën e Kaçanollit (15-18 shtator 1998), betejën e Llapashticës (24-27 dhjetor 1998), betejën e Peranit (9 janar 1999), betejën e Majacit (27 janar 1999), betejën e Prapashticës (7 prill 1999) etj. Gjatë luftimeve në ZOLL ranë heroikisht 154 ushtarë të UÇK-së, ndërsa 181 u plagosën. Trashëguese e Zonës Operative të Llapit ishte Zona e 5-të e Trupave Mbrojtëse të Kosovës dhe më vonë strukturat e tjera të Forcës së Sigurisë së Kosovës. (Ismet Cakiqi)

ZONA OPERATIVE E NERODIMES (ZON). Strukturë organizative territoriale e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), e cila përfshinte territoret e Ferizajt, Shtimes, Lipjanit,

Kaçanikut, Hanit të Elezit dhe Vitisë. Në muajin qershor-korrik të vitit 1998, njësitet e UÇK-së për herë të parë u vendosën në fshatin Greme-Jezerc të Ferizajt. Me shtimin e radhëve dhe zgjerimin e njësiteve në territorin e Ferizajt, Shtimes, Kaçanikut etj., u formua Nënzona Operative e Nerodimes (korrik 1998). Komandant i kësaj nënzona u emërua Shukri Buja, kurse zëvendëskomandant Imri Ilazi. Në korrik të vitit 1998 u zhvillua lufta e parë në mes njësiteve të UÇK-së kundër forcave policore dhe ushtarake të Serbisë, në vendin ku bashkohen lumenjtë në Nerodime. Pas ngritjes së logjistikës në fshatin Jezerc, shtrirjes së njësiteve të UÇK-së dhe konsolidimit të nënzonës, në nëntor të vitit 1998 u formua Zona Operative e Nerodimes. Struktura komanduese e Zonës përbëhej nga komandanti, zëvendëskomandanti, shefi i shtabit, shefat e departamenteve (9 gjithsej), njësitet vartëse të zonës, policia ushtarake, informimi, mjekësia, njësia speciale për ndërhyrje. Në kuadër të ZON-it vepruan Brigada 161 "Ahmet Kaçiku" dhe Brigada 162 "Agim Bajrami". Zona Operative e Nerodimes kishte një rol të veçantë gjatë luftës në përcjelljen e personave me rëndësi dhe sigurimin e rrugës strategjike Kaçanik-Gllboçicë për furnizimin e UÇK-së me armatim. Zona u dallua për disiplinën dhe organizimin e mirë të logjistikës. Në nivel zone funksiononte spitali ushtarak. Komandanti i zonës mbante lidhje të drejtpërdrejta me shefin e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së. Zona Operative e Nerodimes në kufijtë e saj strategjik ka pasur në mbështetje Zonën Operative të Pashtrikut dhe atë të Karadakut. Gjatë luftës tre komandantë brigade kanë rënë dëshmorë, si dhe dhjetëra luftëtarë të tjerë. (Ruzhdi Jashari, Ali Uka)

ZONA OPERATIVE E PASHTRIKUT (ZOP).

Strukturë organizative territoriale e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), e cila përfshinte territorin e komunave: Prizren, Suharekë, Rahovec, Dragash dhe pjesën më të madhe të Malishevës. Ndër celulat e para të UÇK-së në këtë zonë, të udhëhequr nga Mensur Zymberaj, është grupi i Rahovecit në Drenoc, i formuar në vitin 1995. Në vitin 1996 u sulmua stacioni i policisë në Ratkoc, që shënon aksionin e parë të UÇK-së në ZOP. Pas vitit 1997 celula ushtarake e Drenocit u zgjerua në një njësit, i cili ishte i përbërë prej 20 vetash. Në këtë kohë, përveç

grupit të UÇK-së në Drenoc, u formuan edhe njësitë e tjera ushtarake, si njësitë "Çeliku", që vepronte në malet e Berishës, përkatësisht në fshatin Kleçkë. Njësitë ushtarake në vitin 1998 në ZOP u formuan në tërë zonën. Në mars të vitit 1998, në rajonin e Hasit u formuan celulat e para ushtarake me udhëheqës Qazim dhe Hajrush Muhadrin; në koordinim me rajonin e Anadrinisë, me udhëheqës Sabit Gashin dhe Smajl Latifin. Në Opojë u formua Brigadat 127-128, në Vërrin shtabi lokal i Prizrenit, në Dobërdelan shtabi lokal "Lisi" dhe "Çeliku", në Malishevë, Budakovë, Shkozë, si dhe më vonë edhe në fshatra të tjerë të kësaj zone. Të gjitha këto njësite u angazhuan në mënyra të ndryshme në organizim të luftës çlirimtare, posaçërisht për të siguruar rrugët, për të sjellë armatimin nga Shqipëria. Në ZOP u morën nën kontroll nga ana e UÇK-së pikat e larta malore, si Maja e Zatriqit, malet e Budakovës, malet e Vërrinit, Qafa e Duhlës, malet e Berishës etj. Nga qershori i vitit 1998 komandant i ZOP-it ishte Musa Jashari, pastaj Ekrem Rexha, me zëvendëskomandant Sylejman Kollçakun dhe shef të shtabit Nexhmedin Kastratin. Ndërsa gjatë muajve shkurt-mars të vitit 1999 komandant ishte Tahir Sinani, me zëvendëskomandnat Sadik Halitjahën dhe shef të shtabit Nexhmendin Kastratin (më vonë Bajram Bekteshin). Brigadat që e përbënin ZO të Pashtrikut ishin: Brigada 121, me zonë operative Llapushën Lindore dhe Drenicën e Sipërme me komandant Fatmir Limajn, pastaj Ismet Jasharin dhe Haxhi Shalën; Brigada 122 me zonë operative Llapushën Qendrore, me komandant Vllaznim Kryeziun, Gani Krasniqin, Ismet Jasharin, Tahir Sinanin dhe Vesel Maliçin; Brigada 123, e dislokuar në rrethin e Suharekës, me komandant Gëzim Hazrollin; Brigada 124, e dislokuar në rrethin e Rahovecit, me komandant Skënder Hoxhën; Brigada 125, e dislokuar në Vërrin dhe fshatrat e Prizrenit, me komandant Nehat Bashën; Brigada 126, në rajonin e Hasit, me komandant Safet Gashin; Brigada 127-128, e dislokuar fillimisht në Opojë, me komandant Ruzhdi Saramatin. Ndër beteja të shumta kundër forcave armike që u zhvilluan në ZOP veçohen: beteja në Shkozë-Semetisht, Qëndresë, Celinë, Reti, Rahovec, Zatriq, Qafë të Duhlës, Landovicë dhe Gorozhub. Zona Operative e Pashtrikut kishte 5,000-7,000 luftëtarë, prej tyre dhanë jetën 400 dëshmorë. (Bedri Muhadri)

ZONA OPERATIVE E SHALËS (ZOSH). Strukturë organizative territoriale e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), që shtrihet në veri të Kosovës, ndërmjet Zonës Operative të Drenicës dhe të Llapit. Aktivitetin e saj luftarak e zhvilloi përmes aksioneve guerile, luftës frontale dhe aksioneve diversante. Veprimet dhe aksionet e organizuara të UÇK-së kundër forcave serbe në këtë zonë filluan përmes aktiviteteve ilegale e më pas, me formimin e njësiteve ushtarake, edhe me paraqitjen publike të njësitit të parë në pranverë të vitit 1998. ZOSH-i (fillimisht si nënzonë) u themelua më 28 qershor 1998, shtabi i saj kryesor ishte në Ashlan, ndërsa dy ditë më vonë, më 30 qershor, u formua Brigada 141 "Mehë Uka", e cila u pasua nga Brigada 142, si dhe nga njësitet tjera speciale. ZOSH-i kishte edhe njësitin special dhe njësitin e policisë ushtarake. Brigadat kishin nga katër, përkatësisht dy batalione. Komandant i kësaj zone u emërua Rrahman Rama. UÇK-ja në ZOSH ka bërë strukturim dhe ristrukturim, sipas vendimeve të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së. Konsolidimi i radhëve të UÇK-së në këtë zonë u shoqërua me veprime konkrete luftarake ndaj forcave serbe. Veprime të tilla gjatë viteve 1998 dhe 1999 u ndërmoren në disa vija të gjera frontale. Veçohen luftimet në Pantinë e Frashër, beteja e Mazhiqit, Kaçandollit, Majdanit, Melenicës, Ashlanit, Vaganicës; pastaj luftimet përgjatë vijës frontale: Rahovë-Cenaj-Majdan-Melenicë-Trepçali-Mazhiq-Rashan-Pasomë; në vijën frontale Skromë-Ceceli-Dumnicë-Samadrexhë; luftimet rrëzë Çiçavicës në fshtarat: Bukosh, Liqe, Balinc, Dolak, Pantinë, Gurëbardh; luftimet në Druar, Reznik etj. Në vijat e frontit të ZOSH-it dhanë jetën 136 dëshmorë dhe u plagosën 209 ushtarë. Në këtë zonë më 8 janar 1999, në fshatin Bare u zunë rob 7 ushtarë dhe një rreshter i ushtrisë jugosllave. Në bashkëveprim me faktorin ndërkombëtar, u bë lirimi i tyre në këmbim me 9 ushtarë të UÇK-së, të cilët ishin zënë rob natën e 13-14 dhjetorit 1998 në kufirin Shqipëri-Kosovë. Kjo ngjarje e shndërroi jo vetëm Zonën Operative të Shalës, por tërë UÇK-në në një faktor të rëndësishëm politik dhe ushtarak, si dhe përshpejtoi thirrjen e Konferencës së Rambujesë. (Sabit Sylja)

ZONAT E MBROJTURA. Rrjeti Kombëtar i Zonave të Mbrojtura në Kosovë përfshin 173 zona të deklaruara të mbrojtura. Zonat

e mbrojtura përfshijnë sipërfaqen rreth 196,745,01 ha, apo 18.07% të territorit të Republikës së Kosovës. Në këto zona bëjnë pjesë parqet kombëtare (2), monumentet e gjalla dhe jo të gjalla të natyrës (145), rezervate të natyrës (27), peizazhe të mbrojtura (5), park natyre (1) dhe zonë e veçantë e mbrojtur e zogjve (1). Sipërfaqen më të madhe të zonave të mbrojtura në Kosovë e përbëjnë Parku Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" ku përfshihen 62,488 ha dhe Parku Kombëtar "Sharri" me sipërfaqe prej 53,469 ha, apo 10.73% të territorit të vendit. (Behxhet Mustafa)

ZOONOZAT. Grup i sëmundjeve ngjitëse, ku burim i infeksionit janë kafshët. Infeksioni bartet nga kafsha te njeriu me rrugë të ndryshme, por nuk bartet nga njeriu në njeri. Shkaktarë të zoonozave mund të jenë virusët, bakteret dhe parazitët. Disa nga zoonozat paraqiten në formë sporadike (tërbimi, tetanosi, antraksi), e disa të tjera në formë epidemike, duke përfshirë edhe epidemitë familjare. Zoonozat jo vetëm që cenojnë shëndetin e popullatës, por njëkohësisht shkaktojnë humbje të mëdha ekonomike. Në Kosovë janë të pranishme: antraksi, tularemia, ethja Q, tërbimi, ethja hemorragjike Krime-Kongo, bruceleza dhe tetanosi. Antraksi në Kosovë paraqitet herë pas herë, me një apo dy raste lëkurore. Tularemia filloi të regjistrohet pas luftës së fundit, përfshirë edhe epideminë e vitit 1999-2000, me 247 raste e lokalizuar në Rrafshin e Dukagjinit. Deri në vitin 2014 janë regjistruar 1,370 raste të tularemisë, të shpërndara në gjithë territorin e Kosovës. Rastet e tërbimit human nuk janë regjistruar prej vitit 1981. Ethja Q në formë epidemie, është regjistruar në kampin argjentinas të kontingjentit të KFOR-it me bazë në komunën e Prizrenit në vitin 2002. Kampi ushtarak ishte i vendosur në afërsi të fermës së dheneve. Me këtë rast janë infektuar 59 ushtarë argjentinas. (Isme Humolli)

ZVEÇANI. Vendbanim rreth 3 km në veri të Mitrovicës. Në këtë lokalitet njihet fortesa e Zveçanit, e periudhës antike. Perandori bizantin, Justiniani, mbi gërmadhat e fortësës së vjetër, në shek. VI, ngriti fortifikatën e Zveçanit. Në vitin 1120, Zveçani bie nën sundimin e shtetit mesjetar serb. Në defterin kadastral osman (1455) përmendet me emrin Izvedxhan. Evlija Çelebia në shekullin XVII e



ZVEÇANI

përmend qytetin Zveçan me rreth 30 shtëpi, një han e disa dyqane. Në udhëpërshkrimin e Pjetër Bogdanit (1684) për këtë vendbanim thuhet: “Zveçani është i vendosur në një majë mali, me kështjellën e pathyeshme”. Në shënimet statistikore të vitin 1913 përmendet si lagje e fshatit Çerkezi me 42 banorë, ndërsa në vitin 1921 kishte 4 shtëpi me 33 banorë. Sipas regjistrimit serb të vitit 1991, kishte 770 shtëpi dhe sot ka 1, 297 banorë. Përshpejtimin e zhvillimit ekonomik ky vendbanim e përjeton prej vitin 1927, kur kompania angleze “Selection Trust LTD” fillon nxjerrjen e xeheve nga miniera e Trepçës. Edhe sot zhvillimi urban i Zveçanit është i lidhur me kompleksin industrial të Trepçës. Deri në vitin 1991 territori i komunës së Zveçanit i takonte komunës së Mitrovicës. Veprimtaria kryesore ekonomike tradicionalisht ka qenë industria e lidhur me atë ekstraktive të kombinatit Trepça. Në Zveçan është ngritur reparti industrial për shkrirjen e plumbit dhe Zinkut. Zveçani i Ri është ndërtuar brenda një kohe të shkurtër (1947-1950), si qytet industrial me më tepër se 70 ndërtesa të reja banimi, një ose disakatëshe. Vendbanimi ka edhe objekte të tjera të nevojshme për zhvillimin e jetës shoqërore, si: objektin e administratës komunale, shkollën tetëvjeçare dhe të mesme, stacionin shëndetësor, kinemanë, bibliotekën, bankat, objektet tregtare etj. Zveçani, së bashku me Zveçanin e Vogël, në vitin 1991 kishte 1,816 banorë, shumica serbë. (Nazif Gashi)

ZVEÇANI (komuna). Komunë në pjesën veriore të Kosovës. Shtrihet në luginën e Ibrit, e rrethuar nga malet e Kopaonikut, Moknës dhe Rogoznës. Kufizohet me komunën e Mitrovicës, Leposaviqit, Zubin Potokut dhe

Novi Pazarit. Ka reliev të karakterit të ulët malor dhe kodrinor me lartësi mbidetare 700-900 m. Pozita gjeografike është e volitshme, për shkak të lidhjeve të mira komunikuese. Magjistranja automobilistike dhe hekurudha nëpërmjet komunës së Zveçanit e lidhin Kosovën me Serbinë dhe me Ballkanin. Gërmadhat e fortifikimeve dhe gjetjet e tjera arkeologjike dëshmojnë për banimin e hershëm të kësaj zone. Fortifikata e Zveçanit daton që nga antikitetit, mbi gërmadhat e së cilës u ngrit fortesa mesjetare. Gjatë periudhës osmane ishte njësi administrative-territoriale më vete. Pas vitit 1912 bën pjesë në rrethin e Mitrovicës. Në aspektin e zhvillimit ekonomik, ky vendbanim rol të rëndësishëm fiton që nga viti 1927, kur kompania nga Londra “Selection Trust LTD” fillon eksploatimin e xeheve nga miniera e Trepçës. Deri në vitin 1991 ishte në kuadër të komunës së Mitrovicës. Komuna e Zveçanit përfshin qytetin e Zveçanit me 34 vendbanime rurale. Sipas regjistrimit të popullsisë në vitin 1991, kishte 9,609 banorë, nga të cilët shumica serbë dhe 16.2% shqiptarë. Për shkak të zhvillimeve politike, ky numër i shqiptarëve pësoi rënie të vazhdueshme, kështu që (sipas vlerësimeve) në fillim të vitit 1999, në komunën e Zveçanit jetonin 12,000 banorë, prej të cilëve vetëm 400 banorë shqiptarë, kryesisht në fshatrat Boletin, Kelmend dhe Zhazhë. (Nazif Gashi)

ZYBERAJ Bedri (1963-). Pjesëmarrës i luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, studiues i letërsisë, poet. Lindi në Drenoc të Rahovecit. Pasi kreu shkollën e mesme në Rahovec, mbaroi studimet për letërsinë dhe gjuhën shqipe në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës (1988), ku më pas kreu edhe studimet pasuniversitare. Në fillim të viteve '90 punoi në arsim. U mor edhe me aktivitet politik, duke u përfshirë për një kohë në strukturat e Lidhjes Demokratike të Kosovës në Rahovec. Në shkurt të vitit 1998 hyri në radhët e UÇK-së dhe gjatë luftës kreu detyra me përgjegjësi si luftëtar dhe epror i saj. Pas luftës vazhdoi të punojë në Trupat e Mbrojtjes së Kosovës si pedagog dhe më pas shef i shkollës për oficerë të lartë. Gjatë periudhës 2004-2009 u mbajt në arrest, me pretendime se kishte bërë krime të luftës gjatë vitit 1998. Merret me shkrime letrare. Më 1998 botoi përmbledhjen me poezi “Dromca vitesh”, ndërsa në vitin

2013 librin me kritika dhe studime “Në gjurmë të arketipave”. Për një kohë të shkurtër ishte drejtor i Bibliotekës Kombëtare të Kosovës. (Berat Dakaj)

ZYBERAJ Mensur (1965-1999). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Hero i Kosovës. Lindi në Drenoc të Rahovecit. Kreu shkollën e mesme në Rahovec, Fakultetin Ekonomik në Universitetin e Prishtinës më 1985. Gjatë kohës së studimeve ishte aktiv në protesta dhe demonstratat që organizoheshin nga studentët. Për këtë arsye në vitin 1990 u arrestua nga policia serbe. Në shtator të vitit 1996 u bë pjesëtar i UÇK-së. Ai do të bëhet figura qendrore e shtrirjes dhe e organizimit të UÇK-së në rajon të Anadrinisë, që më vonë do të shërbejë si bërthamë e krijimit të Zonës Operative të Pashtrikut. Me bashkëluftatarrë kreu sulmin e parë operativ të UÇK-së në rajonin e Anadrinisë dhe të rrethit të Prizrenit, mbi stacionin e policisë serbe në Ratkoc të Rahovecit. Ky sulm ishte pjesë e sinkronizuar e një operacioni strategjik të UÇK-së në disa qendra të Kosovës, i kryer në të njëjtën kohë dhe me të njëjtin synim. U vra më 28 maj 1999 gjatë luftimeve me forcat serbe. Në vitin 2013 u dekorua nga presidentja e Republikës së Kosovës me Urdhrin “Hero i Kosovës”. (Bedri Zyberaj)

ZYLFIU Nijazi (1936-). Pedagog, profesor universiteti. Lindi në Ferizaj, ku mori edhe arsimin fillor. Më pas kreu Normalen në Prizren dhe studioi pedagogjinë me historinë e artit në



NIJAZI ZYLFIU

Universitetin e Shkupit. Magjistroi në Universitetin e Zagrebit dhe doktoroi në Fakultetin Filozofik në Prishtinë. Fillimisht ishte mësues, pastaj mësimdhënës dhe drejtor i Shkollës Normale në Ferizaj, mësimdhënës në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Shkup, drejtor i Entit Krahinor për Politikë Sociale, këshilltar i arsimit të lartë në Këshillin Ekzekutiv të Kosovës, kryetar i Lidhjes së Shoqatave të Pedagogëve të Kosovës dhe të Jugosllavisë, redaktor i revistës “Pedagogu” (Prishtinë), kryetar i Lidhjes së Defektologëve të Kosovës etj. Për shumë vjet ishte mësimdhënës i didaktikës dhe i pedagogjisë

shkollore në degën e pedagogjisë të Fakultetit Filozofik në Prishtinë. Për qëllime studime dhe si ligjërues qëndroi në disa qendra universitare në Europë. Fushë e interesimit të tij shkencor-profesional janë: didaktika, teoria e mësimimit, andragogjia, edukata seksuale etj. Mori pjesë në shumë konferenca shkencore-profesionale dhe publikoi një varg punimesh në gazeta e revista të ndryshme. Është autor i disa teksteve universitare dhe i botimeve të veçanta: “Mendimet pedagogjike dhe humaniste të Naim Frashërit” (1980), “Edukata seksuale e rinisë shkollore” (1984), “Didaktika” (1985), “Didaktika-teoria e mësimimit” (2005), “Didaktika andragogjike” (2007), “Teoria e mësimimit dhe e proceseve të mësimdhënies” (2011) etj. (Januz Dervodeli)

ZYMBERAJ Mentor (1968-). Aktor, regjisor, mësimdhënës. Lindi në Pejë, ku kreu shkollimin fillor dhe të mesëm, ndërsa studimet për aktrim dhe regji teatri i kreu në Fakultetin e



MENTOR ZYMBERAJ

Arteve të Universitetit të Prishtinës. Luajti në një sërë shfaqjesh teatrore dhe filma artistikë e televizivë. Në vitet '90 luajti në shfaqjet “Shqip-tari me duar në xhepa” (1996), “Monodramë për mua dhe zotin” (1999), ndërsa pas vitit 2000 luajti në shfaqjet e Teatrit Kombëtar të Kosovës: “Orestia”, “Ëndrra e fundit”, “Aktori në kuti”, “Rokenroll”, “Lisistrata”, “Një varr për majorin e mbretit”, “Ku...çka?”, “Amok” etj. Nga filmat ku ka luajtur do veçuar “Kodi i jetës” të E. Kryeziut dhe “Agnus Dei” të A. Sopit. Si aktor është prezantuar me shfaqje në shumë festivale teatrore brenda dhe jashtë vendit, ku është nderuar me shumë çmime dhe mirënjohje, veçmas me shfaqjen “Aktori në kuti”. Që nga viti 1993 është mësimdhënës në degën e aktrimit në Fakultetin e Arteve. Është themelues dhe drejtor i Festivalit Ndërkombëtar të Monodramës në Kosovë “Monoakt” dhe president i Qendrës për Kosovë të Institutit Teator Ndërkombëtar (ITI). (Visar Krusha)

ZYMBERI Abdullah (1944-2017). Gjuhëtar. Lindi në fshatin Ruhot të Pejës. Shkollimin fillor dhe të mesëm i kreu në Istog, Pejë dhe Gjakovë. Shkollën e Lartë Pedagogjike e mbaroi në Prizren, kurse studimet për gjuhë

dhe letërsi shqipe në Fakultetin Filozofik në Prishtinë (1971), ku më pas kreu edhe studimet pasuniversitare. Më 1995 u doktorua rreth leksikut bujqësor dhe blegtoral të të folmeve shqipe në Mal të Zi. Punoi në shkollat e mesme të Prizrenit dhe në Shkollën e Lartë Pedagogjike po në Prizren. Botoi “Fjalorth i fjalëve të rralla” (1979), “Leksiku bujqësor e blegtoral i të folmeve shqipe të Malit të Zi” (1996), dhe “Fjalor popullor me rreth 20,000 fjalë” (2014). Botoi artikuj në fusha të ndryshme të albanologjisë. Është anëtar i Këshillit Ndërkademiç për Gjuhën Shqipe. (Bahri Koskoviku)

ZYMBERI Drinor (1987-). Kompozitor. Lindi në Ruhot të Pejës. Pas Shkollës së Mesme të Muzikës në Prishtinë, studioi drejtimin e kompozimit në Fakultetin e Arteve të UP-së. Ka kompozuar vepra solistike, korale, kamerale (“Alauda arvensis”, Kuartet harkor, “Im Ex Expression”), orkestrale (Simfoni, Lament për orkestër harqesh, piano e perkusione) dhe koncertante (Koncert për orkestër). Ka marrë pjesë në festivale në vend (Ditët e Muzikës Kosovare, Festivali Ndërkombëtar “Re-Musica”, “DAM Festival”, “Tingujt e flautit”) dhe jashtë (Zvicër, Finlandë, Hollandë). Disa prej veprave të tij janë shpërblyer: Çmimi II në konkursin për kompozitor në “Shopen Piano-Fest”, Prishtinë; “Anerkennungspreis” në “Pro-Art Competition for Young Composers”, Zyrih; Çmimi II në Konkursin në “International Kuhmo Competition”. Është pedagog i kompozimit dhe orkestrimit në Fakultetin e Arteve në Prishtinë. (Zeqirja Ballata)

ZYMBERI Erson (1983-). Regjisor. Lindi në Gjilan. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, studimet për regji teatri në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës (2006), ku më pas kreu edhe studimet master. Në Teatrin e Gjilanit bëri regjinë e shfaqjeve “Kumbara” (2007), “Sex, rrena dhe pata tëgra” (2008), “Rekuem” (2010), “Pacienti i dr. Frojdit” (2012) dhe “Ufot” (2015). Në Teatrin Oda inskenoi shfaqjen “Gjithçka 1.5” (2008), në Teatrin e Gjakovës shfaqjen “Koloneli Zog” (2014), ndërkaq në Teatrin Kombëtar të Kosovës shfaqjen “Gishti” (2015). Në vitin 2008 u zgjodh drejtor artistik i Teatrit të Gjilanit. Me shfaqjet e tij u nderua me çmime të ndryshme, si: çmimi për prurje të re teatrore në Festivalin

e Dramës Kombëtare në Gjilan (2011), çmimet për regjisorin më të mirë në Festivalin e Teatrit Shqiptar në Maqedoni (2013) dhe në Festivalin e Dramës Kombëtare në Gjilan (2015). (Bekim Lumi)

ZYMBERI Isa (1946-). Gjuhëtar, përkthyes. Lindi në Pejë, ku përfundoi shkollën fillore dhe të mesmen. Diplomoi për gjuhë dhe letërsi angleze në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës (UP) (1971), ku më vonë kreu edhe studimet pasuniversitare. Punoi si asistent në degën e anglishtes të Fakultetit Filologjik të UP-së (1974-1983) dhe më vonë ligjërues (1983-1990). U mor me studimet kontrastive të shqipes me anglishten në fushën e sistemit emëror. Që nga viti 1990 jeton në Londër. Shkroi për kontributin e Stjuart Manit për albanologjinë. Po ashtu hartoi librin “Kolokium i gjuhës shqipe” (Colloquial Albanian), për mësimin e shqipes për të huajt, botuar në Oksford (2012). U mor edhe me përkthime nga anglishtja në gjuhën shqipe. (Lindita Rugova)

ZYMI. Fshat në komunën e Prizrenit, 12 km në veriperëndim nga qendra. Shtrihet në shpatet lindore të malit Pashtrik, në trevën e Hasit, në lartësinë mbidetare 600 m. Është vendbanim kodrinor i ndarë në lagje, me sipërfaqe 7.7 km². Pjesa dërrmuese e territorit të fshatit është e mbuluar me pyje dhe kullosa, ndërsa ara dhe livadhe ka pak. Si vendbanim përmendet në defterin e sanxhakut të Prizrenit të vitit 1571. Një numër i konsiderueshëm i banorëve të fshatit emigroi brenda dhe jashtë Kosovës. Megjithatë, numri i popullsisë së fshatit Zym shënon rritje të vazhdueshme. Derisa në vitin 1948 fshati numëronte 751 banorë, në vitin 2011 në Zym jetonin 1,782 banorë. Popullsia merret me zeytari (bukëpjekës), blegtori etj. Ka shkollën 9-vjeçare, disa dyqane tregtare, muzeun e fshatit, si dhe disa monumente të trashëgimisë kulturore-historike me rëndësi kombëtare. (Hasim Kryeziu)

ZYRA CIVILE NDËRKOMBËTARE (ZCN). Institucion ndërkombëtar i themeluar sipas Planit Gjithpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës (Plani i Ahtisarit), përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të këtij plani. Zyra Civile Ndërkombëtare paraqiste autoritetin sipëror për interpretimin e dispozitave të

Planit Gjithëpërfshirës, por edhe të zbatimin të masave në rast të shkeljes së dispozitave të tij. Roil i ZCN-së, veçanërisht në vitet e para pas shpalljes së pavarësisë, ishte tejet i pranishëm edhe në emërimin e zyrtarëve në institucione të ndryshme të pavarura, përfshirë Gjykatën Kushtetuese, Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm, Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, të Administratës Tatimore etj. Gjatë funksionimit të saj (2008-2012) Zyra Civile Ndërkombëtare u kryesua nga diplomati holandez Piter Fait. (Irir Dugolli)

ZYRAPI Bislim (1962-). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), ushtarak. Lindi në Studençan të Suharekës. Kreu shkollën e mesme ushtarake në Sarajevë. Shërbeu në Armatën Jugosllave në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe arriti gradën e komandantit të kompanisë kundërtankiste. Në vitin 1992 iu bashkua ush-

trisë së Bosnjës dhe Hercegovinës dhe u emërua komandantë brigade për mbrojtjen e Sarajevës. Më 27 maj 1992 u emërua komandant divizioni. Më pas shërbeu në zonën qendrore të Bosnjës dhe u vendos në Zenica dhe Novi Travnik deri në përfundim të luftës. Në janar të vitit 1995 u largua nga Bosnja dhe u vendos në Holandë. Në mars të vitit 1998 iu bashkua UÇK-së, ndërsa në qershor të vitit 1998 u zgjodh anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, me detyrën e oficerit për zhvillim dhe profesionalizëm në kuadër të Drejtorisë Operative. Në nëntor të vitit 1998 u emërua shef i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, ndërsa në prill të vitit 1999 u emërua zëvendësministër i Mbrojtjes në Qeverinë e Përkohshme të Kosovës. Në periudhën 2000-2009 ishte drejtor i departamentit për menaxhim të emergjencave në Ministrinë e Punëve të Brendshme. (Bedri Muhadri)

ZH

ZHARA-GRUDA Rudina (1976-). Aktore. Lindi në Pejë. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, studimet për aktrim në Fakultetin e Arteve në Universitetin e Tetovës. Ka luajtur në Teatrin Shqiptar të Shkupit në shfaqjet: “Me dyer të mbyllura”, “Mblesëria” dhe “Antigona”. Në Teatrin e Pejës ka luajtur në shfaqjet: “Sfida e madhe”, “Rrëfimet e narkomanëve”, “Memeci që flet”, “Kësulëkuqja”, “Vëlla,vëlla, kosi me dollarë”, “Kur loti ngrin në qepallë”, “Variacionet enigmatike”, “Obelisku pa adresë”, “Pushkatimi” etj. Ka luajtur edhe në disa shfaqje për fëmijë (“Rekordi i përtacisë”, “Këmbëgjati, barkmadhi dhe largpamësi”, “Të vdekur të pavarrosur”, “Zana Prapi dhe magjite e saj”, “Lulja dhe Shega”) dhe në disa shfaqje në Teatrin e Tetovës, në Teatrin e Strugës, në Teatrin “Oda” etj. Krahas teatrit ka luajtur edhe në disa filma dhe seriale televizive. (Naime Beqiraj)

ZHARKU Arben (1982-). Aktor, producent. Lindi në Kaçanik, ku kreu arsimin fillor dhe të mesëm. Kreu studimet për aktrim në Fakultetin e Arteve të Universiteti të Prishtinës më 2004. Mbaroi gjithashtu programin për producent filmi në European Audiovisual Entrepreneur-EAVE (2009). Ishte njëri nga themeluesit drejtues i Festivalit Ndërkombëtar të Studentëve për Film dhe Teatër “Skena UP” (2003-2013). Si aktor luajti në disa shfaqje teatrore dhe filma të shkurtër. Ka qenë producent i disa projekteve filmike. Më 2011 u nderua me çmimin e producentit më të mirë në Festivalin e Filmit në Abu Dhabi. Ka qenë kryesues i këshillit drejtues të Qendrës Kinematografike të Kosovës dhe aktualisht është drejtor i kësaj qendre. (Erson Zymberi)

ZHAVELI Neshet (1955-). Futbollist. Lindi në Gjakovë. Karrierën si portier e nisi në KF “Vëllaznimi”. Më pas e vazhdoi karrierën te

KF “Liria”. U bë pjesë e “brezit të artë” të KF “Prishtina”, duke luajtur në Ligën e parë të ish-Jugosllavisë. Pas Prishtinës e vazhdoi karrierën te “Rijeka” e Kroacisë, ku kaloi një pjesë të mirë të karrierës aktive në futboll. Më pas shkoi në Turqi për disa vjet. Pa dyshim, Zhaveli është njëri prej portierëve më të suksesshëm dhe më të mirë që ka pasur ndonjëherë Kosova. Jeton në Turqi dhe punon si trajner i portierëve në skuadrën “Denizlispor”. (Moral Pozhegu)

ZHDËMTIMI (ZHDËMTIMET E LUFTËS). Është reparacioni, përkatësisht kompensimi i dëmeve sistematike të shkaktuara nga agresori në një vend gjatë luftës. Shpesh kjo ka të bëjë edhe me rikthimin në një gjendje të mëparshme të një prone të caktuar, e cila ka qenë e dëmtuar ose e konfiskuar nga autoritetet e shtetit agresor. Ky obligim i imponohet shtetit agresor që ka pësuar disfatë dhe kjo shpeshherë përfshihet në traktatin e paqes, ku në të shumtën e rasteve përfshihet edhe bashkësia ndërkombëtare. Kosova ka pësuar dëme të mëdha gjatë shumë luftërave, por nuk ka qenë subjekt i të drejtës ndërkombëtare dhe nuk ka arritur të sendërtojë një kompensim, përkatësisht zhdëmtim. Edhe gjatë luftës së fundit (1998-1999) kudër pushtuesit serb janë bërë shumë dëmtime në pasurinë publike e private, sidomos në këtë të fundit. Vlerësimet e dëmeve sillen më shumë se 20 miliardë euro. Delegacioni i Kosovës në bisedimet me Serbinë, me ndërmjetësim të bashkësisë ndërkombëtare, ka paraqitur kërkesën për zhdëmtim nga pala serbe, mirëpo në mungesë të pajtimit të palës serbe, kjo çështje ka mbetur e pazgjidhur dhe për t’u adresuar eventualisht në të ardhmen, në kuadër të dialogut midis dy palëve, ose nëpërmjet një arbitrazhi a gjykate ndërkombëtare. (Muhamet Mustafa)

ZHDRELLA Mentor (1990-). Futbollist. Lindi në Podujevë, hapat e parë të futbollit i nisi te skuadra “2 Korriku” e Prishtinës. Pas një kohe të shkurtër, Zhdrella kaloi te gjeneratat e reja të “KEK-ut”, pastaj u kthye sërish te “2 Korriku”. Nga “2 Korriku”, kaloi te skuadra e “Hysit”, ku qëndroi për një kohë të gjatë dhe fitoi titullin e kampionit të Kosovës dhe Kupën gjithashtu. Në verën e vitit 2014 firmosi dhe u prezentua te “Partizani” i Tiranës, por prapë iu bashkua skuadrës së “Prishtinës” dhe u ftua edhe nga përfaqësuesja e Kosovës. Është futbollisti i vetëm në Kosovë që katër herë ka fituar titullin e lojtarit më të mirë, të shpallur nga Federata e Futbollit të Kosovës (2009-2013). (Tahir Sopi)

ZHEGA Medin (1946-2012). Trajner i futbollit. Lindi në Shkodër. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në qytetin e lindjes, studimet e larta në Institutin e Kulturës Fizike dhe të Sporteve “Vojo Kushi” (sot Akademia e Sporteve). Në periudhën 1963-1979 luajti futboll për ekipet “Vllaznia” dhe “Dinamo”, duke qenë një nga lojtarët më të mirë të vendit. Nga viti 1965 e në vazhdim ishte anëtar i ekipit kombëtar të futbollit. Në vitin 1981 mbaroi shkollën e trajnerëve në Austri. Kreu gjithashtu një seri kualifikimesh për trajner jashtë vendit. Në vitet 1984-1986 punoi si ndihmëstrajner i ekipit kombëtar dhe atij olimpike. Në vitet 1999-2001 ishte trajner i ekipit kombëtar të Shqipërisë. Pas luftës në Kosovë, gjatë vitit 2002, ishte kryetrajner i KF “Prishtina”, si dhe i KF “Vëllaznimi” të Gjakovës. (Besim Kajtazi)

ZHEGRA. Fshat në komunën e Gjilanit në rajonin e Anamoravës. Shtrihet në pjesën jugore të komunës, në trekëndëshin kufitar ndërmjet Kosovës, Serbisë dhe Maqedonisë, në lartësi mbidetare 510 m. Pas Luftës së Dytë Botërore popullsia e fshatit është rritur vazhdimisht. Kjo është manifestuar edhe në transformimin më të shprehur hapësinor dhe funksional, krahasuar me vendbanimet e tjera rurale të kësaj komune. Derisa në vitin 1948 kishte 2,181 banorë dhe 333 ekonomi familjare, në vitin 2011 u regjistruan 3,227 banorë me 574 ekonomi familjare. Popullsia merret me bujqësi, blegtori, tregti dhe veprimtari shërbyese-hoteliere. Është qendër e bashkësisë lokale, në të cilën gravitojnë këto fshatra: Lladovë, Nasalë, Haxhaj, Demiraj, Pidiç, Shurdhan, Goden i Vogël, Çelik, Dunav

dhe Stançiq. Ka shkollën 9-vjeçare, paralelet e ndara të gjimnazit dhe të shkollës ekonomike të Gjilanit, qendrën e mjekësisë familjare dhe disa njësi tregtare. (Nexhat H. Rexha)

ZHERKA Elton (1977-1998). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), dëshmor. Lindi në Gjakovë. Studimet i vijoi në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës. Në fillim të prillit të vitit 1998, pas Epopesë së Prekazit dhe betejës së Glllogjanit, iu bashkuan radhëve të UÇK-së në Glllogjan. Si epror i njësisë speciale për ndërhyrje të shpejta të Zonës Operative të Dukagjinit me bashkëluftëtarët e tij luftoi në Baballoç, Gramaçel, Prilep, Rastavicë, Carrabreg, Voksh, Junik, Hereç etj. Ra heroikisht në njërin ndër betejat më të rrepta që i zhvilloi UÇK-ja kundër forcave serbe, në betejën e Junikut më 10 gusht 1998. U godit nga predhat e tankut të armikut, me çrast u plagos rëndë. Ndërroi jetë më 11 gusht nga plagët e marra. (Fetnete Ramosaj)

ZHERKA Jusuf (1923-2003). Pjesëmarrës i Luftës Nacionalçlirimtare, ish i burgosur politik. Lindi në Gjakovë. Shkollimin fillor e kreu në vendlindje, Normalen-Gjimnazin “Sami Frashëri” në Prishtinë. Ishte pjesëmarrës dhe organizator i demonstratave antifashiste të viteve 1941-1943. Për aktivitetin antifashist arrestohet nga italianët dhe dërgohet në Burgun e Tiranës. Pas kapitullimit të Italisë del nga burgu dhe angazhohet në veprimtarinë antifashiste. Në gusht të vitit 1944 arrestohet nga gjermanët dhe sërish dërgohet në Burgun e Tiranës. Pas arratisjes nga burgu, iu bashkua njësitit partizan të Pezës, më pas kalon në Kosovë merr pjesë në formimin e Brigadës IV të Kosovës. Me formimin e Brigadës VII të Kosovës emërohet komisar batalioni. Në Knin të Vojvodinës angazhohet kundër keqtrajtimet të pjesëtarëve të brigadës nga eprorët serbë, por edhe të Armatës së Kuqe. Në prill të vitit 1945 u kthye në Kosovë dhe u zgjodh sekretar i Organizatës së Rinisë. Në vitin 1947 vijon shkollimin për diplomaci në Beograd. Emërohet ambasador në Kajro (Egjipt). Pas Rezolutës së Informbyrosë përjashtohet nga partia dhe burgoset. Fillimisht vuan dënimin në Burgun e Beogradit dhe pastaj në atë të Goli Otokut. Pas lirimit nga burgu, punoi si përkthyes në Radio Prishtinë dhe në Këshillin Krahinor. (Sulltane Ukaj)

ZHERKA Valbona (1955-). Piktore. Lindi në Prishtinë. Arsimin fillor, gjimnazin dhe studimet për pikturë i mbaroi në Akademinë e Arteve (1977) në Prishtinë. Kreu studimet pasuniversitare për pikturë në Akademinë e Arteve Figurative në Beograd. Në fillim punoi në Radiotelevizionin e Prishtinës si kritike e artit (1985-1990). Si anëtare e Shoqatës së Artistëve Figurativë dhe e Shoqatës së Artistëve Aplikativë të Kosovës mori pjesë në ekspozita të përbashkëta të organizuara brenda dhe jashtë vendit. Hapi disa ekspozita personale: në Prishtinë (1979), Beograd (1979), Prishtinë (1980), Pejë (1982), Gjakovë (1982), Vushtrri (1982) dhe Gjenevë (1996). Piktura e saj shquhet me rrjedhat e artit bashkëkohor, ndërsa tapiceritë e realizuara janë gërshetim mes elementeve autoktone dhe trajtave të ndërthuara kreative. (Rexhep Goçi)

ZHILIVODA Aziz (1912-1994). Veprimtar i lëvizjes nacionaliste shqiptare gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore. Lindi në Zhilivodë (Vushtrri). Më 1941 u rreshtua në radhët e luftëtarëve kundër forcave serbe që kishin sulmuar fshatrat rrëzë Çiçavicës (Zhilivodë, Strofc, Bivolak dhe Bequk). Pas kapitullimit të Jugosllavisë më 1941, futet në xhandarmërinë shqiptare në Orllan, më pas në Lluzhan, Dobratin dhe më së fundi në Besi. Bashkëpunoi me Xhafer Devën, Mehmet Gradicën, Ibrahim Lutfiun, Shaban Polluzhën, Ahmet Selacin etj. Në dimrin e viteve 1943-1944 iu bashkëngjiti forcave të Mbrojtjes Kombëtare në zonën e Artakollit. Në fillim të vitit 1945, me shumë luftëtarë nga Artakolli, iu bashkue Brigadës së Sh. Polluzhës. Pas vrasjes së Sh. Polluzhës, A. Zhilivoda, me bashkëluftarët e tij vazhdoi qëndresën, duke bashkëvepruar me Lëvizjen Nacional-Demokratike Shqiptare. Pushteti komunist jugosllav dhe OZN-a, në pamundësi për ta shtënë në dorë, ia arrestuan familjen, të cilën e mbajtën në burg deri në vitin 1950. Në fund të vitit 1949 kaloi në Shqipëri. Në vitin 1972 në Shqipëri arrestohet dhe dënohet me 20 vjet burg, dënim që e vuajti deri në ditën e fundit. (Muhamet Shatri).

ZHITIA Afrim (1965-1989). Veprimtar politik i lëvizjes ilegale, dëshmor. Lindi në fshatin Lluge të Podujevës, ku kreu shkollimin fillor, ndërsa shkollën e mesme e kreu në Prishtinë. Si nxënës i Shkollës së Mesme Teknike në



AFRIM ZHITIA

Prishtinë, në vitin 1982 përfshihet në organizatën ilegale Fronti Nacionalçlirimtar i Kosovës. Si anëtar i lëvizjes ilegale shpërndau trakte dhe afishe, me të cilat kërkoheshin të drejtat e shqiptarëve dhe denoncimet e pozita koloniale e Kosovës në Serbi dhe në ish-Jugosllavi. Për shkak të aktivitetit të gjerë, grupi i A. Zhitisë u ndoq hap pas hapi nga organet e pushtetit. Në verën e vitit 1984 grupi zbulohet dhe anëtarët burgosen. Në gjyqin që u mbajt për këtë grup, A. Zhitia u dënua me katër vjet burg. Pas daljes nga burgu intensifikoi aktivitetin organizativ dhe e zgjeroi veprimtarinë kundër shtetit dhe pushtetit jugosllav. Më 2 nëntor 1989, në përballje me policinë serbe u vra së bashku me Fahri Fazliun në lagjen Kodra e Diellit në Prishtinë. (Haki Kasumi)

ZHITIA Osman (1942-). Agronom, profesor universiteti. Lindi në fshatin Shakovicë të Podujevës. Shkollimin fillor, të mesëm dhe të lartë bujqësor i kreu në Prishtinë. Kreu studimet në



OSMAN ZHITIA

Fakultetin e Bujqësisë të Universitetit të Beograd (1967). Studimet pasuniversitare i përfundoi në Fakultetin e Bujqësisë të Universitetit të Zagrebit (1973), ndërsa tezën e disertacionit e mbrojti në Fakultetin e Bujqësisë të Universitetit të Shkupit (1982). Kreu specializimin nga lëmi i prodhimtarisë së perimeve në mjedise të mbyllura në Universitetin Bujqësor të Plovdivit, Bullgari (1983). Punoi në shkollën e mesme bujqësore në Lipjan dhe në sekretariatit për çmime të Këshillit Ekzekutiv të Kosovës. Më 1977 u zgjodh asistent në Fakultetin e Bujqësisë për lëndën e perimtarisë. Në vitet vijuese mori titujt përkatës universitarë. Ka botuar tekstin: "Përmirësimi gjenetik i bimëve", me bashkautorë nga Universiteti i Tiranës dhe ka publikuar punime shkencore e profesionale. Është anëtar i Komitetit Republikan për vlerësim të përshtatshmërisë së kultivarëve dhe hibrideve të kulturave bujqësore. (Shukri Fetahu)

ZHUBI Shkëlzen (1939-2000). Piktor, poet, regjisor televiziv. Lindi në Tropojë (Shqipëri). Shkollimin e kreu në vendlindje, ndërsa studimet në Akademinë e Arteve të Bukura në Bratisllavë (Sllovakia) në vitin 1970. Shquhet ndër kultivuesit e parë të ne i teknikës së kolazhit. Ekspozoi pavarësisht në Gjakovë, Mitrovicë, Pejë, Gjiilan, pastaj në Shkup e Tetovë, ndërsa ekspozita të përbashkëta pati më 1971, 1972 dhe 1973 në Bratisllavë, në Galerinë moderne M. P Le Havre, më 1973 në Lion (Francë), në Zagreb, në Galerinë "Forum", pastaj më 1978 në Zarë dhe në Munih, në Galerinë 222 më 1996. Është gjithashtu autor i disa përmbledhjeve me poezi. Ishte nga regjisorët e parë të Televizionit të Prishtinës. (Tahir Emra)

ZHUGRA Alvina (Venediktovna) (1940-). Gjuhëtare ruse, albanologe. Lindi në qytetin Velikie Lluki në rrethin e Pskovit. Studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe i kreu në Universitetin e Leningradit. Më 1966 nisi të punojë në Institutin e Gjuhësisë të Akademisë së Shkencave. Interesimi i saj shkencor shtrihet nga morfologjia, leksiku, etimologjia, dialektologjia, etnolinguistika e deri te folkloristika. Më 1972 mbrojti disertacionin "Koha e ardhme në gjuhën shqipe" (Budušćee vremja v albanskom jazyke). Botoi artikuj kushtuar huazimeve latine dhe turke në gjuhën shqipe, termave fafëfisnorë shqiptarë dhe ballkanikë, historisë dhe tipareve funksionale-semantike të disa foljeve shqipe. Ndër të rëndësishmit janë punimet për gojëtarinë popullore shqiptare dhe traditën folklorike të Veriut, si dhe artikujt për historinë e albanologjisë ruse dhe ndihmesën e A. Desnickajas në studimet albanologjike dhe ballkanologjike. U mor dhe me të folmen e shqiptarëve të Ukrainës. Mori pjesë në aktivitete shkencore albanologjike dhe ballkanologjike, përfshirë Seminarin për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare në Prishtinë. Ligjëroi lëndët leksikologjia dhe leksikografia e shqipes dhe hyrje në albanologji në Universitetin Shtetëror të Shën Petërburgut (ish-Universiteti i Leningradit). Është bashkëpunëtorë e Institutit të Studimeve Linguistike të Akademisë së Shkencave të Rusisë. (Marija Morozova)

ZHUNICA. Fshat në komunën e Preshevës, rreth 5.5 kilometra larg Preshevës. Shtrihet në rrafshin aluvial të Moravicës, në lartësi mbidetare 440-445 m. Sipërfaqja e territorit

të fshatit është 1,667 ha. Në vitin 2002, Zhunica kishte 1,759 banorë rezidentë. Tokat pjellore në rrafshin aluvial dhe afërsia e ujërave nëntokësore mundësojnë kultivimin e perimeve dhe të kulturave të tjera bujqësore. Edhe pse në kushte të tilla, bujqësia është e tipit ekstensiv, ndërsa është mjaft e pranishme dukuria e lënies së tokave djerrinë. Një pjesë e familjeve sigurojnë ekzistencën nga remitancat e mërgatës. Nga objektet e standardit shoqëror, fshati ka shkollën tetëvjeçare, e cila është paralele e ndarë e shkollës fillore të Preshevës. Ndërtimi i shtëpive skaj rrugës Zhunicë-Preshevë, gradualisht po bën bashkëngjitjen e fshatit me zonën periurbane të qytetës së Preshevës. (Arsim Ejupi)

ZHUPANIA. Njësi territoriale-administrative, që u paraqit gjatë shek XIII-XIV të sllavët e jugut dhe të perëndimit. Si njësi territoriale-organizative ishin të pranishme edhe në Mbretërinë Hungareze, e cila këtë nocion e kishte huazuar nga kroatët. Më pastaj kuptimi i kësaj njësie është bartur te Perandoria Habsburge, në viset që banoheshin kryesisht nga popullata sllave. Pas krijimit të Mbretërisë Serbe-Kroate-Sllavene (1918), këto njësi u organizuan edhe brenda këtij shteti dhe qëndruan deri në vitin 1921, kur u shuan me Kushtetutën e Vidovdanit. Sot ky organizim territorial administrativ i mbështetur në sistemin e zhupanive, ekziston në Kroaci dhe Hungari. Mbështetur në burimet mesjetare, zhupat si njësi territoriale-administrative funksionuan pas pushtimit nemanjid të Kosovës, sidomos gjatë shekujve XIII-XIV. Të tilla zhupa i ndeshim në Llap, Prizren, Zveçan, luginat e Ibrit dhe të Lepencit, por edhe në Pollog. Edhe sot në pjesën lindore të qytetit të Prizrenit ekziston territori i përbërë nga disa fshatra, që quhet Zhupa e Prizrenit apo e Sredckës. Po ashtu, si nocion gjeografik në Kosovë ekziston edhe Zhupa e Siriniqit, që shtrihet në rrjedhën e epërme të lumit Lepenc, në pjesën verilindore të maleve të Sharrit. (Muhamet Mala)

ZHURI. Fshat në komunën e Prizrenit, 12 km në jugperëndim të qendrës. Shtrihet rrëzë shpateve malore, afër rrugës automobilistike Prizren-Dragash dhe Prizren-Kukës, në lartësinë mbidetare 500 m. Është vendbanim i tipit të dendur, me sipërfaqe 40.2 km², nga e cila pjesa dërrmuese është e mbuluar me pyje

dhe kullosa, ndërsa ara dhe livadhe ka më pak. Përmendet në defterin e parë osman të Rumelisë (1451-1452) me emrin Zhur dhe kishte 19 shtëpi. Një numër i konsiderueshëm i banorëve emigroi brenda dhe jashtë Kosovës. Megjithatë, për shkak të lëvizjes pozitive natyrore, numri i popullsisë së fshatit vazhdoi të rritet. Në vitin 2011 Zhuri kishte 5,909 banorë, ndaj 1,926 banorë, sa kishte në vitin 1948. Popullsia merret me bujqësi, blegtori, industri (shfrytëzimi i mineraleve dhe gurit gëlqeror), ndërtimtari etj. Është bashkësi lokale, në të cilën gravitojnë disa vendbanime. Ka shkollën 9-vjeçare, shkollën e mesme, disa objekte të shërbimeve komunale, dyqane tregtare etj. (Hasim Kryeziu)

ZHVILLIMI EKONOMIK. Është cilësia e ndryshimeve ekonomike e sociale në një shoqëri, nën ndikimin e rritjes ekonomike. Shpreh mirëqenien, si rezultat i transformimeve sociale e ekonomike dhe ndryshimeve strukturore në një ekonomi, nën ndikimin e industrializimit në shekullin e kaluar dhe zhvillimin e shoqërive postindustriale bashkëkohore, nën ndikimin e shërbimeve me vlerë të lartë shtuese veçanërisht në fushën e teknologjive të informacionit dhe të komunikimeve. Përgjithësisht rritja sjell përmirësim në zhvillimin ekonomik, por jo gjithëherë. Në shoqëri të caktuara rritja ekonomik përdoret nga grupe të caktuara shoqërore për interesa të ngushta grupore apo politike, ose për investime në prestigj, në armatim, veprime që krijojnë diferenca sociale midis grupeve dhe dobësojnë kohezionin social. Se sa do ta përjetojë një shoqëri zhvillimin ekonomik varet nga cilësia e qeverisjes dhe se kush përfiton nga rritja ekonomike, përkatësisht sa shtrihen efektet e rritjes ekonomike në një bazë të gjerë të popullatës në aspektin rritjes së konsumit. Zhvillimi ekonomik do të duhej të kontribuonte në ndryshimet pozitive demografike, si dhe në uljen e varfërisë së popullatës. Në kontekstin e caktuar historik, politik e social, të shoqëruara me sisteme të caktuara të qeverisjes në Kosovë, ka munguar një zhvillim adekuat ekonomik, me një përjashtim të periudhës 1966-1980, andaj për shoqërinë kosovare edhe më tutje mbeten problematike niveli i lartë i papunësisë dhe varfëria (Muhamet Mustafa)

ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM. Një zhvillim që përmbush nevojat e tanishme, pa e rrezikuar aftësinë e gjeneratave të ardhme për të plotësuar nevojat e tyre. Ky koncept promovon idenë se zhvillimi social, ekonomik dhe mjedisor është i arritshëm brenda kufizimeve të burimeve natyrore për zhvillim. Kjo kërkon një baraspeshë midis objektivave të zhvillimit ekonomik, social dhe mjedisor me rastin e përcaktimit të politikave zhvillimore nga qeveritë, bizneset dhe pjesëmarrësit e tjerë. Koncepti i nevojave më shumë u adresohet grupeve të marginalizuara shoqërore dhe të varfërve në botën e sotme, ndërsa koncepti i limitimeve ka të bëjë me nivelin e zhvillimit teknologjik dhe organizimit social lidhur me kapacitetet mjedisore për nevojat e tanishme dhe ato të gjeneratave të ardhshme. Ky problem kundrohët shpesh në një trekëndësh: 1) nevojat e familjeve, shërbimet, rritja e industrisë, rritja e bujqësisë dhe përdorimi eficient i punës; 2) pjesëmarrja e barabartë, fuqizimi i qytetarëve dhe komuniteteve, mobiliteti social dhe mbrojtja e trashëgimisë kulturore; dhe 3) mbrojtja e biodiversitetit, të burimeve natyrore, integritetit të ekosistemit, të ajrit dhe ujit të pastër. Kosova ka probleme serioze me zbatimin e këtij koncepti lidhur me shfrytëzimin e burimeve natyrore, veçanërisht të mineraleve të “Trepçës”, Korporatës Elektroenergjetike, “Ferromikelit” dhe “Sharrcemit”, nga të cilat emitohen gazra dhe mbeturina të tjera, që seriozisht dëmtojnë cilësinë e ajrit, të ujit, të tokës dhe biodiversitetin. Ende nuk është ndërtuar një sistem i të menduarit dhe politikave përkatëse, i cili do të merrte në konsiderim përgjegjësinë e gjeneratave të sotme për kushtet e jetesës dhe zhvillimit të gjeneratave të ardhshme lidhur me shfrytëzimin e burimeve natyrore të papërtëritshme, veçanërisht mineraleve. Konsiderohet se Kosova ka rezerva të shumta minerale të metaleve me ngjyra, linjitet etj. Kjo e rrit përgjegjësinë që në eksplotimin dhe përdorimin e tyre të zbatohen konceptet e zhvillimit të qëndrueshëm. (Muhamet Mustafa)

ZHVILLIMI NJERËZOR. Koncept me të cilin njeriu vihet në qendër të politikave dhe proceseve zhvillimore, duke synuar zgjerimin e mundësive të popullatës për të jetuar sipas zgjedhjeve të tyre dhe për të evituar pamundësitë për të konsumuar ose shfrytëzuar shërbime për shkak të mundësive të kufizuara.

Kjo arrihet duke zhvilluar kapacitetet, dituritë dhe shkathtësitë për pjesëmarrje në rritjen e të ardhurave dhe për të gëzuar shërbime cilësore, veçanërisht në edukim dhe mbrojtje të shëndetit. Niveli i zhvillimit njerëzor (zhvillimi human) matet nëpërmjet indeksit të zhvillimit njerëzor (HDI-Human Development Index), i cili llogaritet duke marrë për bazë këta komponentë: jetëgjatësia, përfshirja në arsim, përqindja e analfabetëve të moshave të mëdha dhe prodhimi i brendshëm bruto për një banor. Ky koncept promovohet veçanërisht nga UNDP-ja, e cila, duke filluar që nga viti 1990 boton raportin e zhvillimit njerëzor global. Në Kosovë raporti i parë i zhvillimit njerëzor është botuar më 2002 dhe vazhdon të publikohet nga UNDP-ja për çdo të dytin vit. Gjykuar sipas indeksit të zhvillimit njerëzor, në vitin 2014 HDI-ja e Kosovës është 0.786, që e kategorizon vendin me një zhvillim njerëzor mesatar, duke e radhitur midis vendit 85-90 nga 170 vendet e përfshira në këtë indeks. Megjithatë, në vitin 2004 ky indeks ishte 7.34. Në nivelin e këtij treguesi ka ndikuar niveli i ulët i të ardhurave për banorë, kurse më pozitivisht shprehet niveli i arsimimit dhe jetëgjatësia. Nivelin më të lartë të indeksit të zhvillimit njerëzor, sipas hulumtimeve të UNDP-së, e ka Prishtina me 0.864, kurse më të ulët komuna e Mamushës prej 0.652. (Muhamet Mustafa)

ZHVILLIMI RURAL. Masa dhe politika komplekse, që përfshijnë transformimin ekonomik dhe social në zonat rurale, në fshatra, kryesisht me zhvillimin e bujqësisë, të sektorëve përplotësues të ndërmarrësisë, përfshirë edhe infrastrukturën fizike, zhvillimin e arsimit dhe të shëndetësisë. Zonat rurale kanë qenë zonat më të dëmtuara nga lufta në Kosovë. Dëmet

kanë qenë në objekte banimi, në objekte të tjera përcjellëse, në mekanizim bujqësor, në blegtori etj. Në një situatë të këtillë, fermerët menjëherë pas luftës kanë qenë të fokusuar më tepër në rindërtimin e objekteve të banimit. Kjo ka ndikuar shumë që të dobësohet aftësia investuese e familjeve rurale në rimëkëmbjen e prodhimit bujqësor. Vendbanimet rurale, ato kodrinore-malore në veçanti, karakterizohen me mungesë të infrastrukturës rrugore. Në fakt, kjo paraqitet si njëri nga faktorët limitues në rritjen e prodhimtarisë bujqësore, në njërin anë, si dhe është një nga faktorët vendimtarë që determinojnë vendimin për ta braktisur fshatin, duke pasur parasysh transportin e vështirësuar dhe ofertën shumë të varfër të shërbimeve. Gjithashtu, edhe furnizimi me ujë të pijshëm në viset rurale të Kosovës ende nuk është i atillë, që të mundësojë furnizim cilësor. Një numër vendbanimesh që gjinden bri rrugëve magjistrale apo afër qyteteve të mëdha janë të lidhura me sistemet e ujësjellësit publik. Në shumë fshatra kanë ndërtuar me vetëkontribut sisteme të vogla të ujësjellësve lokalë, cilësia e të cilëve nuk kontrollohet sa duhet. Duke marrë parasysh sipërfaqen e kufizuar të tokës për një familje, dendësinë e popullsisë, është e qartë se në kushtet e Kosovës vetëm bujqësia nuk mund të sigurojë zhvillim të suksesshëm rural. Për këtë arsye, në viset rurale janë duke u zhvilluar disa biznese që mund të kenë perspektivë edhe më tutje, si përpunimi i drurit, që kohëve të fundit ka marrë hov, pastaj përpunimi i produkteve bujqësore, biznese për grumbullimin e kërpudhave dhe frutave pyjore, bletaria, bimët mjekuese etj. Një mundësi tjetër është turizmi rural, i cili deri më tani nuk ka pasur zhvillim të qëndrueshëm. (Skënder Kaçi)

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
FJALORI ENCIKLOPEDIK I KOSOVËS

Prishtinë, 2018

Dizajni grafik dhe faqosja: Samir Haliti & Agon Çeta

Lektorë: Bahri Koskoviku, Shefqet Riza

Shtypi: Focus-Print, Prishtinë-Shkup

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

030(=18)

Fjalori enciklopedik i Kosovës / kryeredaktor dhe redaktor përgjegjës
Mehmet Kraja. - Prishtinë: Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës,
2018. – 2 libra: ilustr.; 26 cm.

[Vëllimi] II: L-ZH. – VI, 938-1818 f.

Titulli paralel në gjuhën shqipe dhe angleze.

1.Kraja, Mehmet

ISBN 978-9951-615-84-6

ISBN 978-9951-615-86-0

ISBN 978-9951-615-86-0



9 789951 615860